

# KURANI I SHENJTË



arabisht-shqip  
me komentim të shkurtër



# KURANI I SHENJTË

arabisht-shqip  
me komentim të shkurtër



Islam International Publications Ltd.

Tiranë, 2023

# KURANI I SHENJTË

arabisht-shqip,  
me komentim të shkurtër

THE HOLY QUR'ĀN

*Arabic Text and Albanian Translation, with Short Commentary*

Botimi i parë: Tiranë, (Albania) 2023  
(*First Edition*)

Përktheu në shqip: Samad Ahmed Ghorri  
(*Translated into Albanian by*)

Redaktuan: Prof. dr. Muhamet Peci, Prof. Rexhep Hasani  
(*Proofread by*)

Botues (*Published by*):



Fondacioni Xhemati Musliman Ahmedia i Shqipërisë  
Tiranë, Shqipëri (Albania)

*Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohet në ndonjë formë apo me çfarëdo mjeti, elektronik a mekanik, duke përfshirë fotokopje, regjistrim ose ndonjë sistem të ruajtjes e të marrjes së informacionit, pa lejen paraprake me shkrim nga "Islam International Publications Ltd".*

© Islam International Publications Ltd.

U shtyp në shtypshkronjën:  
(*Printed at*)

ISBN: 9789928449160

*për më shumë, në shqip:*

[www.alislam.al](http://www.alislam.al)

[www.ahmadiyya-islam.org/al](http://www.ahmadiyya-islam.org/al)



*in English:*

[www.alislam.org](http://www.alislam.org)

## Përmbajtja

Rreth Kuranit të Shenjtë .....	V
Parathënie .....	XIII
Pasqyra e sureve të Kuranit të Shenjtë .....	XV
Kurani i Shenjtë .....	1
Lutje kur mbaron leximin e Kuranit të Shenjtë .....	1194
Indeksi i disa prej temave të Kuranit të Shenjtë .....	1195
Bibliografia .....	1295
Shkurtesat .....	1299
Shpjegimet e fjalëve të huaja .....	1299
Kontakte .....	1301



# Rreth Kuranit të Shenjtë

*Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.*

*O Zot! Lartësoje Muhammedin dhe popullin e tij, ashtu siç e lartësove Ibrahimin dhe popullin e tij! Me të vërtetë, Ti je i Lavdëruar, i Nderuar!*

*O Zot! Bekoje Muhammedin dhe popullin e tij, ashtu siç e bekove Ibrahimin dhe popullin e tij! Me të vërtetë, Ti je i Lavdëruar, i Nderuar!*

Kurani i Shenjtë, Fjala e pastër e Zotit të Madhërishëm, i shpallur në zemrën e çiltër të Profetit Muhammed, paqja dhe bekimet e Allahut gjithmonë qofshin mbi të, i ruajtur dhe i mbartur gjer më sot në formën origjinale të tij, është Libri i Shenjtë i të gjithë besimtarëve muslimanë dhe do të mbetet i tillë deri në Ditën e Gjykimit. Sipas Kuranit, Zoti i Madhërishëm dërgoi Profetët e tij te çdo popull, po kështu, disa Libra të tjerë përpara Kuranit, duke u kujdesur për zhvillimin shpirtëror, moral dhe shoqëror të njeriut. Libri përfundimtar prej Tij u zbrit në formën e Kuranit, dhe për këtë arsye, Ai krijoi mundësi e rrethana, të cilat nuk lejojnë asnjë ndërhyrje në të. Për shembull, Kurani u shkrua sure më sure e ajet më ajet, tek po zbritej. Kurani që në kohën e Profetit<sup>savs</sup>, me porosinë Hyjnore, filloi të recitohej në gjuhën origjinale në namazet e pesë vakteve. Që gjatë jetës së Profetit qindra sahabë vijuan ta mësonin përmendsh gjithë Kuranin, traditë kjo që vijon edhe sot e kësaj dite. Sot në botë mund të gjeni miliona muslimanë që e dinë gjithë Kuranin përmendsh. Zoti, përveçse siguroi mbrojtjen tekstuale të Kuranit, i dha edhe mbrojtje kuptimore, duke ngritur në krye të çdo shekulli të Islamit nga një reformator (*muxheddid*),<sup>1</sup> i cili i udhëzoi muslimanët që të mos e keqinterpretinin Kuranin. Kështu premtimi i Zotit:

*“Sigurisht, Ne e zbritëm këtë Këshillë dhe sigurisht, Ne do ta mbrojmë atë.”*  
(15:10),

sa vjen e bëhet më madhështor.

## Emra të ndryshëm të Kuranit të Shenjtë

Kurani ka emra të ndryshëm të përmendur në Kuran dhe në hadithe. Disa prej tyre që janë përmendur edhe në Kuran, janë: *Kuran* (50:2), *Furkan* (dallues) (25:2), *Dhikr* (këshillë ose kujtesë) (15:10) *Adhim* (i madhërishëm) (15:88), *Kerim* (i nderuar) (56:78), *Burhan* (argument), *Nur* (dritë) (4:175), *Rahmeh* (mëshirë), *Shifa* (shërim) (17:83), *Hudā* (udhëzim) (41:45) etj..

---

1. Ebu Davud, nr. 4291.

## Historiku i zbritjes së Kuranit

Kurani i Shenjtë filloi të zbritet në muajin e Ramazanit (2:186), i cili në kalendarin islam është muaji i nëntë. Pra, në një rën prej ditëve të këtij muaji të bekuar, Profetit Muhammed<sup>savs</sup> i erdhi shpallja e parë Kuranore në shpellën Hira, që ndodhet në afërsi të Mekës. Më pas, për 23 vitet e ardhshme, Kurani do të zbritet, pak nga pak, për të përfunduar gjatë jetës së Profetit<sup>savs</sup>. Sipas kalendarit gregorian, kjo periudhë i përket gjysmës së parë të shekullit VII.

Suret e para sipas renditjes kronologjike, janë: surja 96 El-Alek, surja 68 El-Kalem, surja 73 El-Muzzemmil, surja 74 El-Muddeththir.

## Ajeti i parë dhe ajeti i fundit sipas kohës së zbritjes

Ajeti i parë i Kuranit që iu zbrit Profetit në shpellën Hira, është nga surja 96 El-Alek: *“Lexo me emrin e Zotit tënd që krijoi.”* (96:2)

Kurse ajeti i fundit është nga surja 5 El-Maideh: *“... Sot, kam përsosur fenë tuaj për ju dhe jua kam plotësuar bekimin Tim dhe kam pëlqyer Islamin për ju si fe...”* (5:4)

## Suret dhe ajetet

Kurani ndahet në kapituj që quhen *sure*. Suret përbëhen nga vargje që quhen *ajete*. Emrat e sureve janë vendosur që gjatë jetës së Profetit<sup>savs</sup>. Madje, disa sure kanë më shumë se një emër. Kurani ka gjithsej 114 sure. Për sa i përket numrit të ajeteve, ka mendime të ndryshme. Por kjo nuk do të thotë se kopje të ndryshme të Kuranit kanë ajete të ndryshme. Jo. Ndryshimi është vetëm në përcaktimin e numrit të ajeteve, gjë që vjen për disa arsye. Për shembull, disa *“Bismil-lahin...”* që vjen në krye të çdo sureje, nuk e llogarisin si ajet të parë të çdo sureje, por vetëm të sures El-Fatiha, kurse disa të tjerë, duke përfshirë edhe Xhematin Musliman Ahmedia, e llogarisin atë si ajet të parë të çdo sureje, me argumentin se ai është pjesë e Kuranit. Për këtë, lexoni 2:1. Kështu, numri i ajeteve të Kuranit duke përfshirë *Bismil-lahin* si ajet të parë, është 6,348.

## Suret mekase dhe ato medinase

Siç dihet që pas profetërisë, Profeti Muhammed<sup>savs</sup> jetoi 13 vite në Mekë, më pas, për shkak të persekutimeve të ashpra të mekasve, mërgoi në Medinë, ku do të jetonte edhe 10 vite të tjera. Nisur nga kjo ndarje historike e jetës së tij, edhe suret ndahen në dy kategori: 1) mekase dhe 2) medinase. Kështu, numërohen 86 sure të zbritura në Mekë dhe për këtë arsye quhen *mekase*, kurse 28 sure të tjera janë zbritur pas mërgimit në Medinë dhe për këtë arsye quhen *medinase*. Megjithatë, ka edhe sure, të cilat pjesërisht janë zbritur në Mekë dhe pjesërisht në Medinë.



## Renditja e Kuranit

Ndërsa Kurani po zbritet në bazë të zhvillimeve që ndodhnin gjatë jetës së Profetit<sup>savs</sup>, Profeti<sup>savs</sup>, me udhëzim Hyjnor, i rendiste suret ndryshe, në bazë të tematikës së tyre. Prandaj, ka shumë sure që janë zbritur në vitet e para, por që ndodhen në pjesën e fundit në Kuran. Ashtu siç ka sure, që janë zbritur në periudhën medinase, por që ndodhen në pjesët e para të Kuranit. Renditja aktuale e Kuranit nuk është arbitrare, përkundrazi, lidhjet e sureve shpalosin tematika nga më të larmishmet.

## Kurani u shkrua që në kohën kur u zbrit

Çdo herë kur zbriteshin ajete të caktuara, Profeti i porosiste sahabët që dinin shkrim e këndim, t'i shkruanin ato. Atëherë Kurani shkruhej nëpër degë hurme, nëpër gurë,<sup>2</sup> në shpatulla devesh, kuajsh a delesh etj.<sup>3</sup> Ndër sahabët e parë që shkruan Kuranin sipas porosisë së Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, ishin *Hazret Zejd bin Thabiti<sup>ra</sup>*, *Hazret Ebu Bekri<sup>ra</sup>*, *Hazret Osmani<sup>ra</sup>*, *Hazret Omeri<sup>ra</sup>*, *Hazret Aliu<sup>ra</sup>* etj..

## Mbledhja dhe kopjet e para të Kuranit

Kurani ishte shkruar nëpër sende të ndryshme. *Hazret Ebu Bekri<sup>ra</sup>*, gjatë Kalifatit të tij, porositi *Hazret Zejd bin Thabitin<sup>ra</sup>* t'i mblidhte ato dhe t'i bënte një libër. Gjatë Kalifatit të *Hazret Osman bin Affanit<sup>ra</sup>*, Kalifi i kohës përgatiti disa kopje të këtij libri dhe i dërgoi ato në vende të ndryshme muslimane. Ndërkohë, gjatë kësaj periudhe, kishte me qindra muslimanë, të cilët e dinin gjithë Kuranin përmendsh. Në këtë mënyrë, Kurani i Shenjtë në arabisht që ekziston në botë, është identik me Kuranin që na ka dhënë Allahu i Madhërishëm përmes të Dërguarit të Tij<sup>savs</sup>. Më shumë për këtë temë, lexoni te 15:10.

## Ndarja sasiore e Kuranit për lehtësinë e lexuesit

Përveç ndarjes në *sure* (kapituj) dhe *ajete* (vargje), e cila është një ndarje semantike dhe që u bë gjatë kohës së Profetit<sup>savs</sup>, Kuranit iu bënë edhe disa ndarje të tjera, të cilat janë sasiore dhe u bënë më vonë. Ndër to janë *menzilë*, *xhuze*, *ruku* ose *hizbë* etj.. I gjithë Kurani është i ndarë në 7 *menzilë* dhe 30 *xhuze*, në mënyrë që një lexues që dëshiron ta lexojë Kuranin brenda 30 ditëve, lehtësisht mund t'i përmbahet ndarjes së *xhuzeve*, kurse ai që dëshiron ta lexojë brenda 7 ditëve, mund t'i ndjekë *menzilët*. *Xhuzet* më tej janë ndarë në *ruku* ose *hizb*. *Rukuja* është relativisht më e vogël se *hizbi*. Kështu, *rukutë* janë 558, dhe *hizbët* 60, por çdo *hizb* ndahet në 4 nëndarje të tjera. Në këtë botim, ne kemi ndjekur sistemin e *rukuve*.

---

2. Buhari, nr. 4986.

3. Ebu Bekr ibn Ebi Davud, "Kitab el-Mesahif", f. 14.

## Recitimi dhe studimi i Kuranit të Shenjtë

Kurani i Shenjtë duhet recituar dhe studiuar vazhdimisht dhe me vëmendje. I Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> tha:

“Ai që përfundoi leximin e të gjithë Kuranit brenda tri ditëve, nuk kuptoi asgjë prej tij.”<sup>4</sup>.

Po kështu, ai tha:

“Kushdo që lexon qoftë një shkronjë të Kuranit, Allahu i Madhërishtëm e shpërblen atë dhjetëfish; dhe unë nuk them se *elif.lam.mim* përbëjnë një shkronjë, por *elifi* është një shkronjë, *lami* është një shkronjë dhe *mimi* është një shkronjë.”<sup>5</sup>

Metoda më e mirë për recitimin dhe studimin e Kuranit të Shenjtë është që, më së pari, sipas porosisë së Allahut (16:99), duhet t'i kërkoh mbrojtjen Allahut nga djalli i mallkuar, pra të lutesh me fjalët “*E'ūdhu bil-lāhi minesh-shejtānirr-rraxhīm*”. Pas kësaj, ta fillosh me emrin e Allahut të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit, pra, të thuash “*Bismil-lāhirr-Rrahmānirr-Rrahīm*”. Po kështu, Kurani që në fillim pohon se ai është udhëzim për ata që kanë druajtje (2:3), pra për ata që kanë turp të refuzojnë të vërtetën, të hyjnë në mëkat dhe që vazhdimisht përpiqen të pastrohen shpirtërisht.

Pas kësaj përgatitjeje, Kuranin duhet ta lexosh në atë mënyrë që kudo që vjen ndonjë lutje, edhe ti të lutesh; kudo që lexon për mëshirën e Zotit, t'ia kërkoh atë; kudo që sheh se po flitet për ndëshkimin e keqbërësve, t'i kërkoh mbrojtje Zotit nga vepra të tilla etj..

## Mrekullia e elokuencës së Kuranit të Shenjtë

Në shumë ajete të tij, Kurani sfidon mohuesit që, nëse ata dyshojnë në vërtetësinë e këtij Libri, të sjellin një libër të ngjashëm me të, ose ndonjë sure si suret e tij, ose ndonjë ajet si ajetet e tij. Ai gjithashtu pohon se mohuesit, edhe sikur të bashkohen që të gjithë, nuk mund të sjellin dot ndonjë shembull të tij. Duke përshkruar disa nga mrekullitë e gjuhës së Kuranit, Themeluesi i Xhematit Musliman Ahmedia, *Hazret Mirza Ghulam Ahmed*<sup>as</sup> i Kadianit, shërbëtori i përsosur i Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, thotë:

“Kurani i Shenjtë ka disa cilësi të paarritshme, si për shembull: 1) Elokuenca dhe shprehësia e tij, që është krejt e veçantë nga shprehësia njerëzore. Shprehësia e njeriut është e ngushtë, dhe për këtë arsye, ajo nuk mund të quhet e përsosur pa pasur trillime, sajesa e gjëra të panevojshme. 2) Mrekullia e dytë e paarritshme e Kuranit është që të gjitha historitë, që janë përmendur

---

4. Tirmidhi, nr. 2949

5. Tirmidhi, nr. 2910.

në të, përbëjnë edhe profeci, gjë për të cilën vetë Kurani herë pas here e ka shprehur. 3) Mrekullia e tretë e paarritshme e Kuranit të Shenjtë është që mësimi i tij ka të gjithë potencialin e nevojshëm për ta përsosur natyrën dhe karakterin e njeriut dhe se i ka të gjitha argumentet që janë të nevojshme për njeriun për ta arritur shkallën më të lartë të bindjes. 4) Mrekullia e katërt shumë e madhe e Kuranit është që ai e afron ndjekësin e përsosur të tij me Zotin, aq shumë sa që Zoti e bekon atë me komunikimin Hyjnor; ndjekësi arrin pastrimin shpirtëror dhe qëndrueshmërinë e besimit në nivelin më të lartë sipas kapacitetit të tij, dhe Zoti përmes tij shfaq shenja të qarta. Megjithatë, është një pikë me rëndësi që na tregon Kurani, se ky bekim që gëzon njeriu i përsosur përmes Kuranit, nuk është vlerë e tij personale, por një dhuratë prej Zotit, dhe për këtë arsye, edhe ndjekësi i përsosur nuk e quan këtë si arritje të tij personale. Vlera e besimtarit të përsosur është deri te druajtja e tij ndaj Zotit, pastërtia e tij shpirtërore dhe qëndrueshmëria e tij në besim. Për shembull, nëse një mur pasqyron dritën e diellit, drita nuk quhet veti e murit. Vetia e murit është pastërtia e tij dhe se po qëndron i palëkundur në baza aq të forta, të cilat mund të mbajnë mbi supe një pallat të tërë.”<sup>6</sup>

## Komentimi i Kuranit të Shenjtë

Zoti i Madhërishtëm thotë në Kuranin e Shenjtë: *“Dhe për çdo gjë Ne kemi thesaret e saj dhe Ne nuk e zbresim atë, përveçse në një sasi të përcaktuar.”* (15:22). Kështu, Zoti ua shpalos edhe kuptimet e Kuranit robërve të Tij të zgjedhur në kohë të ndryshme, në bazë të nevojave shpirtërore të njeriut. Në lidhje me këtë, Ai pohon në Kuran:

“... interpretimin e tyre nuk e di askush, përveç Allahut dhe të thelluarve në dije (që) thonë: “E besuam; gjithçka është prej Zotit tonë.” (3:8).

Në shumë hadithe të Profetit Muhammed<sup>savs</sup> gjejmë komentim të një sërë ajetesh të Kuranit të Shenjtë. Robërit e sinqertë të Zotit e komentojnë Kuranin e Shenjtë në dritën e fjalëve të Profetit<sup>savs</sup>. Për këta robër të Tij, të cilëve Zoti ua mëson Kuranin, Ai thotë:

“Sigurisht, ky Kuran është i nderuar; (i ruajtur) në një Libër të fshehtë. Asnjë nuk e prek dot, përveç të pastërve.” (56:78-80)

Duke e shpjeguar këtë ajet, Themeluesi i Xhematit Musliman Ahmedia, Mesih i Premtuar dhe Imam Mehdi<sup>as</sup> thotë:

“Kuptimi i këtyre ajeteve është që Zoti u zbulon të vërtetat e Kuranit vetëm atyre, që janë të pastër shpirtërisht. Kjo për arsye se njeriu me zemër të pastër ka një ngjashmëri me Kuranin e Shenjtë dhe për shkak të kësaj ngjashmërie, njohuritë e Kuranit shpalosen në zemrën e tij të pastër dhe ai arrin t'i njohë

---

6. “Çeshm-e-ma’rifet”, “Ruhani Khazain”, vëll. 23, 2009, Mbretëria e Bashkuar, f. 268.

ato, t'i nuhasë ato, dhe zemra e tij e pohon – ja, kjo është e vërteta. Pra, drita e zemrës së tij bëhet një kriter i përshtatshëm për ta peshuar të vërtetën. Derisa njeriu nuk krijon ngjashmëri me Kuranin dhe nuk bëhet i gatshëm për të kaluar në rrugën e ngushtë ku kanë kaluar Profetët, paqja qoftë mbi ta, ai nuk duhet të bëhet komentues i Kuranit, sepse do të ndjekë rrugën e mosrespektimit dhe të vetëpëlqimit, dhe në një gjendje të tillë, ai do të bëjë vetëm komentim nga vetja, nga e cila i Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> na ka ndaluar duke thënë – gaboi ai që komentoit Kuranin nga vetja, edhe pse në mendjen e tij e komentoit bukur<sup>7</sup>.<sup>8</sup>

## Kurani i Shenjtë të siguron edhe argumente të logjikshme e shkencore

“Dy gjëra që duken se janë zbatuar në Kuranin e Shenjtë, nga fillimi deri në fund: (1) janë argumentet e tij të logjikshme dhe (2) janë dëshmitë Hyjnore. Të dyja këto aspekte rrjedhin si dy lumenj paralelisht në të gjithë Kuranin, duke ndikuar dhe duke mbështetur njëri-tjetrin. Rrjedha e argumenteve të logjikshme i thotë lexuesit – *kështu duhet të jetë*. Kurse rrjedha tjetër, ajo e dëshmimeve të shpalljeve, si një lajmëtar fisnik dhe i besueshëm ia qetëson zemrën duke thënë – *pikërisht kështu ndodhi*.”<sup>9</sup>

“Kurani siç e qetëson një njeri të pashkolluar, në të njëjtën mënyrë i jep përgjigje bindëse edhe një filozofi që kërkon argumente të logjikshme.”<sup>10</sup>

“Besimi ynë është që, sa më shumë që do të zhvillohet shkenca, aq më fort do të vendoset në botë madhështia e Kuranit të Shenjtë.”<sup>11</sup>

Për më shumë rreth kësaj teme, u sugjerojmë lexuesve të lexojnë “*Introduction to the Study of the Holy Quran*” të Kalifit të Dytë të Xhematit Musliman Ahmedia, *Hazret Mirza Bashiruddin Mahmud Ahmed*<sup>ra</sup>.

## Disa nga veçoritë e këtij botimi

Për hir të lexuesit, është e udhës të shënohen shkurtimisht disa nga veçoritë e këtij përkthimi të Kuranit të Shenjtë.

### *Besnikëri ndaj Origjinalit në përkthimin e ajeteve të Kuranit*

Së pari, është bërë përpjekje që përkthimi në shqip i ajeteve të Kuranit të jetë sa më pranë Origjinalit, pra tekstit në arabisht, dhe çdo fjalë e shtuar për hir të përkthimit, është vënë në kllapa. Fjalët në kllapa janë vendosur në atë mënyrë që fjalia edhe pa to

---

7. Tirmidhi, nr. 2952.

8. “Berekatud-dua”, “Ruhani Khazain”, vëll. 6, 2009, Mbretëria e Bashkuar, f. 19.

9. “Berahin-e-Ahmedia” pj. II, “Ruhani Khazain”, vëll. 1, 2009, Mbretëria e Bashkuar, f. 19.

10. “Mubahathe Lud’hiana”, “Ruhani Khazain”, vëll. 4, 2009, Mbretëria e Bashkuar, f. 110.

11. “Malfuzat”, vëll. 2, 1984, f. 87.

të ketë kuptim, në mënyrë që lexuesi të ketë një pamje të qartë se çfarë është thënë në fjalët origjinale të Kuranit të Shenjtë. E gjithë kjo, në disa vende, mund ta ketë bërë rrjedhën e fjalisë edhe të vrazhdë, megjithatë, në një drejtim me Originalin.

### *Parathëniet e sureve*

Çdo sure është shoqëruar me një parathënie të shkurtër, e cila jo vetëm që zbulon këndshëm kuptime të fshehta të sures, por edhe e ndihmon lexuesin për të krijuar lidhje mes sureve. Parathëniet e sureve janë nga Kalifi i Katërt i Xhematit Musliman Ahmedia, *Hazret Mirza Tahir Ahmed*, Allahu e mëshiroftë, të cilat ai i ka shkruar në përkthimin e tij të Kuranit të Shenjtë në gjuhën urdu, “Kuran-e-Kerim”, që u botua për herë të parë në Mbretërinë e Bashkuar, në vitin 2000.

### *Komentim i shkurtër*

Ky botim gjithashtu sjell shpjegim dhe komentim të shumë ajeteve, që janë bërë nën dritën e *haditheve* (thënieve) të Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, e që shpalosin domethënie të thella të Kuranit, lidhjen mes ajeteve të tij dhe tematikën e larmishme që ka ky Libër madhështor. Këto shpjegime, sa të mbushura me spiritualizëm, aq edhe të pasura me argumente të logjikshme dhe shkencore, janë marrë nga burimet si vijon:

- *Hazret Mirza Ghulam Ahmed*, Mesih i Premtuar, Imam Mehdi, paqja qoftë mbi të: (1) Përmbledhja e veprave të tij, që titullohet “*Ruhani Khazain*”, është botuar në 23 vëllime. (2) “*Malfuzat*”, thëniet dhe fjalimet e tij që janë në 10 vëllime.
- *Hazret Hafiz Maulvi Hakim Nurudin<sup>ra</sup>*, Kalif i Parë i Xhematit Musliman Ahmedia: (3) Komentim i Kuranit, i titulluar “*Hakaikul-Furkan*” në 4 vëllime.
- *Hazret Mirza Bashiruddin Mahmud Ahmed<sup>ra</sup>*, Kalif i Dytë i Xhematit Musliman Ahmedia: (4) “*Tefsir-e-Sagir*”, përkthim me komentim të shkurtër të Kuranit në gjuhën urdu, i botuar për herë të parë në dhjetor 1957. (5) “*Tefsir-e-Kebir*”, komentim i gjerë i Kuranit, i botuar në 10 vëllime (rreth dhjetë mijë faqe), që përbën një thesar të paçmueshëm të dijeve të Kuranit të Shenjtë. (6) “*The Holy Quran - Arabic Text with English Translation and Short Commentary*”, i botuar për herë të parë në 1967 në Pakistan, me shpjegime të ajeteve nga dy burimet e fundit të përmendura më lart. (7) “*Five-Volume Commentary of the Holy Quran*”, i botuar për herë të parë në Mbretërinë e Bashkuar, në vitin 1988, që është përmbledhje në anglisht e komentimit të gjerë në urdu, të titulluar “*Tefsir-e-Kebir*”.
- *Hazret Hafiz Mirza Nasir Ahmed*, Kalif i Tretë i Xhematit Musliman Ahmedia<sup>ra</sup>: (8) Komentim i Kuranit, i botuar në 3 vëllime, i titulluar “*Envarul-Kuran*” që përbëhet nga fjalimet e tij.
- *Hazret Mirza Tahir Ahmed*, Kalif i Katërt i Xhematit Musliman Ahmedia<sup>ra</sup>: (9) Nga përkthimi i tij i Kuranit në gjuhën urdu, i titulluar “*Kuran-e-Kerim*”, përveç parathënieve të sureve, janë marrë edhe shpjegimet e ajeteve. (10) Disa komente

janë marrë edhe nga libri i tij fenomenal “*Revelation, Rationality, Knowledge and Truth*”, i botuar për herë të parë në Mbretërinë e Bashkuar, në 1998. (11) Po kështu, disa edhe nga ligjëratat e tij për përkthimin e Kuranit, të njohura si “*Tarjamatul Quran Class*”, që gjenden në portalin alislam.org.

- *Hazret Mirza Masrur Ahmed, Kalif i Pestë i Xhematit Musliman Ahmedia, Allahu e ndihmoftë fuqimisht: (12) Disa komente janë marrë edhe nga hutbet e tij të të xhumave.*

Burimet e përmendura më sipër janë mijëra faqe, që përbëjnë një oqean të pafundme të dijeve për Kuranin e Shenjtë, kurse në këtë përkthim të Kuranit në gjuhën shqipe, kemi sjellë vetëm disa pika, për të cilat, në burimet e cituara janë studiuar vetëm shpjegimet e ajeteve të përzgjedhura, dhe jo e gjithë literatura nga fillimi deri në fund. Megjithatë, përzgjedhja e tyre ka qenë një detyrë jo e lehtë, pasi ishte e vështirë të zgjidheshin qoftë edhe kaq pak shënime prej tyre, të cilat të mund të sillnin larmi në tema, por edhe librit të mos i shtohet një vëllim i dytë.

*Librat e haditheve, fjalorët, tefsiret (komentimet) e mëparshme të Kuranit, enciklopeditë etj., që janë cituar në shpjegimet e ajeteve të Kuranit, janë pasqyruar në bibliografi në fund të librit.*

### *Indeksi i disa prej temave të Kuranit të Shenjtë*

Duke përfutur nga indeksi i “*The Holy Quran - Arabic Text with English Translation and Short Commentary*”, si dhe i “*Kuran-e-Kerim*” i *Hazret Mirza Tahir Ahmed, Kalif i Katërt i Xhematit Musliman Ahmedia*<sup>ra</sup>, në fund të librit është paraqitur një indeks i gjerë i disa prej temave të Kuranit të Shenjtë, që, në dashtë Allahu, do të jetë në dobi jo vetëm të lexuesve të zakonshëm, por edhe të atyre që synojnë një studim më të thelluar të Kuranit.

## Temat e Kuranit janë të pafundme

Duhet theksuar se, as parathëniet e as komentimet nuk janë të vetmet shpjegime e as shteruese të temave të Kuranit. Temat e Kuranit janë të pafundme, siç theksohet edhe në parathënien e sures 108, duke shpjeguar emrin *Keuther*:

“Një kuptim tjetër i *keutherit* është edhe Kurani i Shenjtë. Realisht, sihariqi më i madh që Allahu i ka dhënë Profetit<sup>savs</sup> është pikërisht Kurani i Shenjtë, temat e të cilit nuk do të shterojnë kurrë, dhe ky Libër do të vijojë t’i sjellë dobi njerëzimit deri në Kiamet. Askush nuk do të mund t’i përmbledhë temat e këtij Libri të Shenjtë.” (f. 1180).

**Botuesi**

# Parathënie

Lavdia është e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit që i mundësoi Xhematit Musliman Ahmedia të Shqipërisë t’ju paraqesë përkthimin e ri të Kuranit të Shenjtë në gjuhën shqipe. Në fakt, Xhemati ynë ka botuar përkthimin e Kuranit edhe më parë, të titulluar “*Kurani Kerim*”, që u botua në vitin 1990, e u ribotua me korrigjime në 2003, përkthim të cilin e kishte bërë i nderuari Muhammad Zakaria Khan i vetëm dhe në një kohë jo të lehtë. “*Kurani Kerim*” vijon t’u shuajë lexuesve të tij etjen për dije dhe për kuptimet rreth Kuranit. Allahu e shpërbleftë për sakrificat dhe për punën e çmuar të përkthyesit! Amin!

Në kushtet e reja lindi si domosdoshmëri një përkthim i ri i Kuranit, i cili të ishte sa më pranë Originalit. Xhemati Musliman Ahmedia i Shqipërisë dhe ai i Kosovës i bënë kërkesë *Hazret* Mirza Masrur Ahmedit, Kalifi i Pestë i Mesihut të Premtuar, Udhëheqës botëror i Xhematit Musliman Ahmedia, Allahu e ndihmoftë fuqimisht, për të nisur punimet e përkthimit të ri. *Hazret* Kalifi i Pestë i Xhematit<sup>aba</sup> ua miratoi kërkesën dhe ngarkoi të nderuarin Samad Ahmed Ghori me këtë përgjegjësi të rëndësishme dhe të shenjtë. Është e pamundur ta falënderojmë Allahun e Madhërishtëm për mirësitë e Tij, që përfundimisht ky përkthim sot sheh dritën e botimit.

Në këtë përkthim të Kuranit të Shenjtë, suret janë të shoqëruara me nga një parathënie të shkurtër, të cilat janë marrë nga Kalifi i Katërt i Xhematit Musliman Ahmedia, *Hazret* Mirza Tahir Ahmed, Allahu e mëshiroftë, nga përkthimi i tij i Kuranit të Shenjtë në gjuhën urdu, i titulluar “*Kuran-e-Kerim*”.

Ky botim gjithashtu sjell shpjegim dhe komentim për shumë ajete, në mënyrë që lexuesit të njihen edhe me thellësinë e temave të Kuranit të Shenjtë. Këto shpjegime janë nën dritën e haditheve të sakta të Profetit Muhammed<sup>savs</sup> dhe përbëjnë një thesar të madh të dijeve shpirtërore dhe shkencore. Të gjitha shpjegimet e ajeteve janë marrë nga literatura e shërbëtorit të vërtetë të Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, *Hazret* Mirza Ghulam Ahmed i Kadianit, Mesih i Premtuar dhe Imam Mehdi, si dhe nga literatura e Kalifëve të tij të nderuar. Librat e haditheve, fjalorët, *tefsiret* (komentimet) e mëparshme të Kuranit, enciklopeditë, etj., që janë cituar në shpjegimet e ajeteve, janë pasqyruar në bibliografi në fund të librit.

Detyrën e redaktimit e kryen Prof. dr. Muhamet Peci dhe Prof. Rexhep Hasani, anëtarë të devotshëm të Xhematit të Kosovës. Po kështu, i nderuari Dr. Bujar Ramaj, Zëvendëspresident i Xhematit të Shqipërisë, i nderuari Jinahuddin Saif, President i Xhematit të Kosovës, i nderuari Sali Beja, i nderuari Besmir Yveysi dhe i nderuari Shamsudeen Malabari, Misionar i Xhematit në Kababir, i erdhën në ndihmë përkthyesit në aspekte të ndryshme. Veç tyre, janë edhe një sërë anëtarësh të

Xhematit, të Shqipërisë dhe të Kosovës, që lexuan pjesë të ndryshme nga përkthimi dhe dhanë sugjerime të vyera. Allahu i shpërbleftë që të gjithë, pa masë! Zoti e bëftë këtë botim një fener udhëzimi për kërkimtarët e së vërtetës! Amin!

Munir-ud-Din Shams

*Add. Vakilut-Tasnif*

(Drejtor i botimeve të Xhematit Musliman Ahmedia)

Maj, 2023



## Suret e Kuranit të Shenjtë

<i>Nr.</i>	<i>Surja</i>	<i>faqja</i>	<i>Nr.</i>	<i>Surja</i>	<i>faqja</i>
1.	El-Fatiha	1	30.	Er-Rum	681
2.	El-Bekare	6	31.	Lukman	693
3.	Ali 'Imran	82	32.	Es-Sexhde	701
4.	En-Nisa	124	33.	El-Ahzab	708
5.	El-Maide	167	34.	Sebe	728
6.	El-En'am	199	35.	Fatir	741
7.	El-A'raf	234	36.	Ja-Sin	752
8.	El-Enfal	275	37.	Es-Saffat	764
9.	Et-Teube	292	38.	Sad	784
10.	Junus	322	39.	Ez-Zumer	798
11.	Hud	344	40.	El-Mu'min	814
12.	Jusuf	366	41.	Ha-Mim Es-Sexhde	831
13.	Er-Ra'd	386	42.	Esh-Shura	843
14.	Ibrahim	398	43.	Ez-Zukhruf	858
15.	El-Hixhr	410	44.	Ed-Dukhan	871
16.	En-Nahl	424	45.	El-Xhathije	878
17.	Beni Israil	448	46.	El-Ahkaf	885
18.	El-Kehf	469	47.	Muhammed	894
19.	Merjem	491	48.	El-Fet'h	902
20.	Ta-Ha	505	49.	El-Huxhurat	911
21.	El-Enbija	525	50.	Kaf	917
22.	El-Haxh	544	51.	Edh-Dharijat	924
23.	El-Mu'minun	561	52.	Et-Tur	932
24.	En-Nur	577	53.	En-Nexhm	938
25.	El-Furkan	594	54.	El-Kamer	947
26.	Esh-Shuara	609	55.	Er-Rrahman	954
27.	En-Neml	631	56.	El-Vakia	965
28.	El-Kasas	649	57.	El-Hadid	975
29.	El-'Ankebut	666	58.	El-Muxhadile	984

## Suret e Kuranit të Shenjtë

<i>Nr. Surja</i>	<i>faqja</i>		<i>Nr. Surja</i>	<i>faqja</i>
59. El-Hashr	991		87. El-A'la	1127
60. El-Mumtehine	998		88. El-Gashije	1130
61. Es-Saff	1003		89. El-Fexhr	1133
62. El-Xhumu'a	1007		90. El-Beled	1137
63. El-Munafikun	1011		91. Esh-Shems	1140
64. Et-Tegabun	1014		92. El-Lejl	1144
65. Et-Talak	1019		93. Ed-Duha	1147
66. Et-Tahrim	1024		94. El-Inshirah	1150
67. El-Mulk	1029		95. Et-Tin	1152
68. El-Kalem	1034		96. El-'Alek	1154
69. El-Hakka	1041		97. El-Kadr	1157
70. El-Me'arixh	1047		98. El-Bejjine	1159
71. Nuh	1052		99. Ez-Zilzal	1162
72. El-Xhinn	1058		100. El-'Adijat	1164
73. El-Muzzemmil	1063		101. El-Karia	1166
74. El-Muddeththir	1067		102. Et-Tekathur	1168
75. El-Kijame	1073		103. El-'Asr	1170
76. Ed-Dehr	1079		104. El-Humeze	1172
77. El-Murselat	1084		105. El-Fil	1174
78. En-Nebe'	1090		106. Kurejsh	1176
79. En-Naziat	1095		107. El-Ma'un	1178
80. 'Abese	1100		108. El-Keuther	1180
81. Et-Tekvir	1104		109. El-Kafirun	1182
82. El-Infitar	1109		110. En-Nasr	1184
83. El-Mutaffifin	1112		111. El-Leheb	1186
84. El-Inshikak	1116		112. El-Ihlas	1188
85. El-Buruxh	1120		113. El-Felek	1190
86. Et-Tarik	1124		114. En-Nas	1192

## Surja 1 – El-Fatiha

El-Fatiha zbriti në fillim të periudhës mekase. Sipas disa rrëfimeve autentike, për herë të dytë ajo zbriti edhe në Medinë. Bashkë me *bismil-lahin*, ajo ka shtatë ajete.

El-Fatiha është përmbledhje e gjithë tematikës së Kuranit të Shenjtë, prandaj në hadithe përmendet që ajo gjithashtu quhet “Ama e Librit”. Përveç emrit El-Fatiha, ajo ka edhe emra të tjerë, siç janë: “Çelësi i Librit” [Tirmidhi, nr. 247], “Salati”, “Lavdia”, “Ama e Kuranit”, “Shtatëvargëshi i përsëritur” [Buhari, nr. 4474], “Shërimi”, “Thesari” etj..

Themeluesi i Xhematit Musliman Ahmedia, *Hazret Mirza Ghulam Ahmedi*<sup>as</sup>, ka shkruar një komentim të gjerë të kësaj sureje në gjuhën arabe përmes dijes së veçantë që Allahu i dhuroi atij.



1. Me emrin e Allahut,<sup>1</sup> të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ۞

2. Lavdia është e Allahut, Zotit<sup>2</sup> të botëve;<sup>3</sup>

الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ ۞

3. të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit;<sup>4</sup>

الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ۞

4. Sunduesit të Ditës së Gjykimit.<sup>5</sup>

مَلِكِ يَوْمِ الدِّينِ ۞

5. Vetëm Ty të adhurojmë<sup>6</sup> dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.<sup>7</sup>

إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ ۞

6. Na udhëzo në rrugën e drejtë.<sup>8</sup>

إِهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ ۞

7. Në rrugën e atyre që i bekojnë,<sup>9</sup> që nuk tërhoqën zemërim dhe që nuk devijuan.<sup>10</sup>

صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ ۞  
غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ ۞

1. *Allah* është emri i Zotit, i Qenies Supreme. Ai është i Vetmi që zotëron të gjitha cilësitë e përsosura, dhe është i pastër dhe i lirë nga të gjitha dobësitë e imagjinueshme. Në gjuhën arabe, fjala *Allah* nuk përdoret kurrë për ndonjë gjë a qenie tjetër. Emrat e Zotit që gjenden në gjuhë të tjera shënojnë ndonjë ose disa tipare të Zotit, dhe shpesh ata përdoren edhe në shumës, kurse emri *Allah* nuk përdoret kurrë në numrin shumës. *Allah* është fjalë e parme, e thjeshtë, jo e prejardhur dhe nuk përdoret kurrë si fjalë cilësuese.

2. Folja *rab-be* do të thotë, ai administroi një çështje, rriti dikë, zhvilloi e përmirësoi dikë, çoi deri në fund një punë të caktuar, mbajti dikë dhe u kujdes për të. Kështu *rab* do të thotë, (a) Zot, Mjeshtër, Krijues; (b) Ai që mbështet dhe zhvillon; (c) Ai që krijon diçka dhe e çon shkallë-shkallë drejt përsosmërisë (Mufredat). Në varësi të kontekstit, kjo fjalë përdoret edhe për persona ose qenie të tjera përveç Zotit.

3. Fjala *el-'ālemīn* është shumësi i *ālem* (botë). Rrjedh prej fjalës *ilm*, që do të thotë *dije*. Çdo gjë që vjen në dijeni, përfshihet në *ālem*. Po kështu, të gjitha qeniet a sendet, me anë të të cilave njeriu mund të njohë Krijuesin, përfshihet në kuptimin e kësaj fjale (Akrab). Shumësi i kësaj fjale nënkupton jo vetëm të gjitha llojet e qenieve ose sendeve të krijuara, por edhe klasat ose kategoritë e tyre. Kur dikush thotë *alemul-ins*, do të thotë *bota e njerëzve*, *alemul-hajavan* do të thotë *bota e kafshëve*. Fjala *ālemīn* përfshin jo vetëm Tokën, por të gjithë trupat qiellorë, galaktikat dhe çdo gjë e universit që vjen në dijeninë e njeriut.

Veç kësaj, fjala *ālemīn* përfshin të gjithë popujt dhe kombet, të gjitha epokat dhe kohët. Zoti e nisi Kuranin e Shenjtë me këtë ajet edhe për të hedhur poshtë besimin e gabuar të atyre popujve, të cilët e monopolizojnë kujdestarinë e Zotit vetëm për popullin e vet, duke përjashtuar popujt e tjerë nga ndikimi i këtij atributi të Tij, sikur ata të mos jenë fare krijesa të Tij, ose gjoja Ai, pasi i krijoi, t'i ketë lënë përjetësisht në harresë.

Ky ajet hedh dritë edhe mbi evolucionin. Allahu është *Rab* i të gjitha botëve, do të thotë se Ai i krijon ato, e më pas i shpie shkallë-shkallë drejt përsosmërisë. Pra, sipas Kuranit, koncepti i evolucionit nuk bie ndesh me besimin në Zot, por përkundrazi. Megjithatë, koncepti që paraqet ky ajet nuk është identik i njëjtë me teorinë e evolucionit që kuptohet nga shumë njerëz sot në botë. Sipas Kuranit, evolucionin e ka një Zot dhe është Ai që krijon dhe bën seleksionimin (28:69), kurse sipas teorisë që paraqesin evolucionistët, krijimin dhe seleksionimin e bën rastësia. Këtë të fundit, ajeti e hedh poshtë duke pohuar se edhe krijimi, edhe seleksionimi po e lavdërojnë Zotin (*Rabbīn*) me anë të përsosurisë së tyre. Ky ajet gjithashtu pohon se njeriu është krijuar për të pasur progres të pambarim, gjë që e tregon kuptimi thelbësor i emrit *Rab* – që zhvillon diçka shkallë-shkallë drejt përsosmërisë.

4. Në ajetin “*Bismil-lah...*” atributet *Err-Rrahman* (mëshirë e përgjithshme, që vjen pa kërkuar) dhe *Err-Rrahim* (mëshirë për ata që punojnë dhe e kërkojnë) shërbejnë si çelës për të kuptuar gjithë suren, po kështu edhe suret e tjera të Kuranit. I Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> tha: “*Err-Rrahman është mëshira ndaj botës. Err-Rrahim është mëshira ndaj ahiretit*” (Ebu Hajjani, vëll. I, fq. 125). Kurse përmendja e këtyre dy emrave këtu ka një funksion shtesë, lidhjen mes attributeve “*Rabbil-ālemīn*” dhe “*Māliki jeumiddīn*”.

5. Fjala “*din*” ka shumë kuptime: shpërblim, shpagim, gjykim, llogaridhënie, sundim, bindje; fe, etj. (Lane). Këto katërtribute të Zotit, pra, *Zoti i botëve*, *i Gjithëmëshirshmi*, *Mëshirëbërësi dhe Sunduesi i Ditës së Gjykimit* janëtribute themelore. Atributet e tjera të Zotit janë shpjeguese të këtyre katërtributeve, të cilat janë si katër shtylla të *Arshit* (Fronit) të Tij. Renditja e këtyre katërtributeve hedh dritë mbi mënyrën se si Zoti ia shfaq njeriut cilësitë e Tij. Atributi *Rabbil-ālemīn* (Zoti i të gjitha botëve) nënkupton se Zoti krijoi njeriun, gjithashtu edhe mjedisin e nevojshëm për përparimin dhe zhvillimin e tij. Më pas vepron atributi, *Err-Rrahman* (i Gjithëmëshirshmi), nëpërmjet të cilit, Zoti i dhuron njeriut të gjitha mjetet dhe aftësitë e nevojshme për përparimin e tij moral dhe shpirtëror. Dhe kur njeriu fillon t'i përdorë këto mjete dhe aftësi, të dhuruara prej Zotit, fillon të veprojë atributi *Err-Rrahim* (Mëshirëbërësi) për të shpërblyer veprat e njeriut. Së fundi, atributi *Māliki jeumiddīn* (Sunduesi i Ditës së Gjykimit) shkakton rezultatet përfundimtare dhe kolektive të punës së njeriut. Ndonëse llogaria përfundimtare dhe e përsosur do të bëhet në Ditën e Gjykimit, procesi i shpërblimit dhe i ndëshkimit vazhdon edhe në këtë jetë, me ndryshimin që në këtë botë veprimet njerëzore shpesh gjykohen dhe shpërblehen edhe nga njerëz të tjerë, mbretër, sundimtarë, shtete, etj., prandaj këtu gjithmonë ekziston mundësia e gabimit dhe e padrejtësisë. Kurse në Ditën e Gjykimit, Sundimi në mënyrë ekskluzive dhe absolute do të jetë vetëm i Zotit dhe shpërblimi dhe ndëshkimi do të jenë tërësisht në dorën e Tij. Aty nuk do të ketë asnjë gabim, askujt nuk do t'i bëhet padrejtësi dhe çdokush do të shpërblehet më shumë sesa ka punuar. Fjala “*Sundues*” gjithashtu tregon faktin se Zoti nuk është thjesht një gjykatës që është i detyruar të japë gjykimin e tij në mënyrë rigorozë në përputhje me një ligj të përcaktuar. Duke qenë Sundues, në Ditën e Gjykimit, Ai mund të falë kë të dojë, dhe të ndëshkojë kë të dojë, ku do të mbizotërojë edhe falja, edhe parimi që askujt nuk do t'i bëhet padrejtësi aspak.

6. Forma e kohës së kryer të thjeshtë të fjalës *na'budu* është *abede* (adhuroi). Sipas fjalorit: “abede Allahu do të thotë iu nënshtrua Allahut, uli kokën përpara Tij, i shërbeu, zbatoi me rregullsi porosinë e fesë së Tij dhe pranoi njëshmërinë e Tij” (Akrab). Një kuptim tjetër i fjalës *abd* është të ndjekësh gjurmët e tjetrit. Në arabisht thuhet *tarikun muabbedun* [*muabbedun* vjen nga *abd*], d.m.th. një rrugë është shkelur kaq shumë saqë është sheshuar nga gjurmët e këmbëve (Lisan el-Arab, zëri: *abd*). Kështu, *ibadet* do të thotë që njeriu të largojë çdolloj shtrembësie dhe të rrafshojë “tokën” e zemrës aq pastër, siç e rrafshon dhe e pastron bujku tokën e tij. Pra, edhe robi ka nevojë të pastrojë “tokën” e zemrës nga gurët, të sheshojë vendet e ngritura, dhe ta pastrojë aq shumë, saqë aty të mbetet vetëm shpirti. Ky është procesi i *ibadetit* për shpirtin. Po këtë pastrim kur i bën pasqyrës, aty sheh fytyrën tënde në mënyrë të pastër. Kur ia bën tokës, ajo lulëzon dhe nxjerr fruta të shumëllojshme. Andaj, edhe njeriu nëse ia bën këtë pastrim zemrës së tij, duke hequr çdo “gur” të panevojshëm, duke rregulluar çdo shtrembësi të saj dhe duke sheshuar çdo ulje-ngritje, ai do të arrijë ta shohë Zotin në pasqyrën e zemrës së tij. Një përkushtim të tillë njeriu mund ta bëjë vetëm për Qenien që zotëron katër atributet e përmendura më lart. Ky është një nga kuptimet e të qenit rob (*abd*) i Allahut, sepse prej kësaj fjale vjen edhe fjala *abd*, që në shqip zakonisht e përkthejmë *rob*. Pra, *abdullah*: *rob i Allahut*. Andaj lexuesi duhet të ketë parasysh se rob i Allahut nuk është në kuptimin e të qenit skllav, por në kuptimin që ka fjala *ibadet*.

7. Fjalët, *vetëm Ty të adhurojmë*, janë vendosur përpara fjalëve, *vetëm Ty të kërkojmë ndihmë*. Kjo sepse njeriu, pasi të njihet me cilësitë madhore të Zotit, në mënyrë të vetvetishme do të dojë ta adhurojë Atë. Por, siç u tha në komentin e mëparshëm, adhurimi është një proces gjithëpërfshirës dhe jo i lehtë, andaj, ai ka nevojë për ndihmën e Zotit gjatë këtij rrugëtimi. Përdorimi i numrit shumë në këtë ajet na tërheq vëmendjen te disa pika: (a) se njeriu nuk është i vetëm në këtë botë, por është pjesë përbërëse e shoqërisë që e rrethon, andaj, ai duhet të ketë dëshirë të rrugëtojë drejt Zotit jo thjesht vetëm, por të marrë edhe familjen, shoqërinë etj., dhe për këtë t'i lutet Zotit; (b) derisa njeriu nuk e reformon mjedisin dhe gjithë shoqërinë e tij, ai nuk është i sigurt.

8. Kjo lutje mbulon të gjitha nevojat e njeriut – materiale dhe shpirtërore, të tashmen dhe të ardhmen e tij. Besimtari lut Zotin që Ai t'i prijë në rrugën e drejtë, në rrugën më të sigurt dhe më të shkurtër. Ka raste kur atij që i tregon rrugën e saktë, ai nuk shkon drejt saj, ose nuk arrin t'i përmbahet dhe e ndërpret rrugëtimin në mes. Kjo lutje e nxit besimtarin që ai të mos kënaqet vetëm duke e parë rrugën e drejtë, por të tregohet këmbëngulës për t'iu drejtuar asaj dhe për të arritur deri në destinacion. Ky pikërisht është kuptimi i fjalës arabe *ihdina* (*na udhëzo*), që, siç e tregon vetë Kurani, do të thotë tregoj rrugën (90:11), i prij rrugën diku (29:70) dhe e mundësoj dikë të ndjekë rrugën e drejtë (7:44) (Mufredat dhe Beka). Realisht, njeriu në çdo hap dhe në çdo moment ka nevojë për ndihmën e Zotit, andaj, është e nevojshme që ai t'i përmbahet kësaj lutjeje. Gjithashtu, fjala *mustekim* do të thotë edhe i qëndrueshëm. Andaj, ne duhet t'i kërkojmë Zotit qëndrueshmëri në rrugëtimin tonë drejt Tij dhe se rruga e drejtë është rruga më e qëndrueshme. Në hadithe janë përmendur shumë bekime të sures El-Fatiha. I Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> tha: “Një sure të tillë si *Ummul-Kur'an* (*Suren El-Fatiha*) Zoti i Madhërishtëm nuk e ka zbritur as në Teurat e as në Inxhil. Ajo gjithashtu është shtatëvargëshi i përsëritur dhe rreth saj, Zoti më tha mua: Ajo është e ndarë në mënyrë të barabartë midis Meje dhe robit Tim, dhe çfarëdo lutjeje që të bëjë robi Im përmes saj, do t'i pranohet.” (Nesai, nr. 914). Nuk do të thotë se do t'ju pranohet çfarëdo lutjeje që të bëni përmes sures El-Fatiha,

kjo dihet. Por, nëse përdorni mjetet ose parimet që janë përmendur në këtë sure për pranimin e lutjes, lutja juaj do të pranohet patjetër.

9. Besimtari i vërtetë nuk mjaftohet vetëm duke ardhur në rrugën e drejtë ose duke bërë disa vepra të mira. Ai ka synimin shumë më të lartë se kaq. Ai përpiket të arrijë një pozicion, ku Zoti e bekon atë. Andaj, ai shikon shembujt e bekimeve Hyjnore që u janë dhënë të zgjedhurve të Zotit dhe inkurajohet prej tyre. Madje, ai nuk ndalet as me kaq, por përpiket shumë dhe lutet, që të përfshihet në mesin e atyre që i ka bekuar Zoti. Këta të bekuarit janë përmendur në 4:70.

10. Frazja *gajril-magdubi alejhim ve led-dal-lin* është shpjegim plotësues (بدل) i frazës paraardhëse *en'ame alejhim*. Andaj, kuptimi është – na trego rrugën e të bekuarve, të cilët nuk shkaktuan zemërimin (Tënd) dhe që nuk devijuan (nga rruga e drejtë). Por dihet që të bekuarit nuk mund t'i përkasin asnjërës prej dy kategorive që janë përmendur këtu. Atëherë çfarë kuptimi mund të ketë lutja? Përgjigjja është që konteksti na tregon se kjo lutje është kolektive, pra për gjithë popullin. Një popull që fiton bekimet e Zotit, pas një kohe të caktuar, edhe mund të shkaktojë zemërimin e Zotit ose edhe mund të bëhet i devijuar, ose të dyja bashkë. Andaj, El-Fatiha na mëson të lutemi që ne të kemi bekimet e Zotit edhe në fillim, edhe në fund, dhe të mos ndodhë që me kalimin e kohës, nga populli i bekuar të kthehemi në njerëz që shkaktajnë zemërimin e Zotit ose që devijojnë nga rruga e drejtë. Pra, nuk është fjala thjesht për një individ, por siç e tregon edhe vetë lutja që është në shumës, bëhet fjalë për të gjithë ne si popull musliman. Si e tillë, kjo lutje do të ishte pikërisht për kohën pas Profetit<sup>savs</sup> dhe pas sahabëve të tij. Edhe vetë *Hazret* Profeti Muhammed<sup>savs</sup> kështu e shpjegoi, kur e pyetën – o i Dërguari i Allahut, cilët janë ata që tërhoqën zemërimin dhe ata që devijuan, dhe Profeti iu përgjigj – hebrenjtë dhe të krishterët. Ai gjithashtu tha – Ashtu siç këpuca i ngjan këpucës tjetër, edhe populli im patjetër do t'u përngajë popujve të mëparshëm (Tirmidhi, nr. 2641). Shkurt, Profeti Muhammed<sup>savs</sup> e ka treguar se *ata që tërhoqën zemërimin dhe ata që devijuan*, ishte një profeci që do të ndodhte jo në kohën e tij, por pas tij, në kohën e rënies së muslimanëve. Kjo lutje natyrisht që paralajmëroi rrezikun, megjithatë, solli edhe shpresën, sepse lutja bëhet për diçka që mund të ndodhë dhe jo për diçka të pamundur. Aq më tepër një lutje e Kuranit, që kurrë nuk mund të jetë për diçka të pamundur. Andaj, lutja është edhe shpresëdhënëse se në një kohë kur muslimanët do të pësonin rënie, dhe një grup prej tyre nëse përpiket të mos bëhet nga ata që tërhoqën zemërimin, e as nga ata që devijuan, përpjekja dhe lutja e tyre me ndihmën e Zotit do t'u sjellë sukses. Dhe kjo është shpresë e madhe për muslimanët.

Për të lexuar më gjerësisht komentim të kësaj sureje të bekuar, mund të lexoni librin “*Komentim i Sures El-Fatiha*”, nga *Hazret* Mirza Bashiruddin Mahmud Ahmed<sup>ra</sup>, botuar në Tiranë, 2018.

## Surja 2 – El-Bekare

Surja El-Bekare zbriti gjatë vitit të parë e të dytë të periudhës medinase. Bashkë me *bismil-lahin* ajo ka dyqind e tetëdhjetë e shtatë ajete.

Kjo sure që në fillim flet për besimin në Allahun e Madhërishëm, në shpalljen prej Allahut dhe në komunikimin me Të, në *ahiretin* etj.. Në suren El-Fatiha u fol rreth tri grupeve: ata që gëzuan bekime, ata që tërhoqën zemërim dhe ata që devijuan. Në El-Bekare, pasi përmendet edhe një herë grupi i parë, pra ata që gëzuan bekime, flitet gjerësisht rreth besimeve dhe veprave të gabuara të atyre që tërhoqën zemërimin.

Kjo sure në vetvete është një mrekulli, sepse jo vetëm që sjell ndodhi të ndryshme të Profetëve duke filluar nga i pari e gjer te *Hazret* Profeti Muhammed<sup>savs</sup>, por edhe shënjon rreziqet që mund t'i dalin Islamit deri në Ditën e Kiametit. Pas përmendjes së *Hazret* Ademit<sup>as</sup>, sureja El-Bekare flet për disa nga Profetët e mëdhenj që njihen nga fetë kryesore të botës, ndër të cilët janë: *Hazret* Ibrahim<sup>as</sup>, *Hazret* Musai<sup>as</sup>, *Hazret* Isai<sup>as</sup> dhe *Hazret* Profeti Muhammed<sup>savs</sup>. Duke studiuar këtë sure, na duket sikur Sheriati u kompletua dhe nuk i mbeti asnjë aspekt pa u cekur. Ndonëse edhe suret që vijnë, sjellin vështrime të tjera, kjo sure duket sikur i përmbledh të gjitha. Në një hadith thuhet se i Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> ka thënë: “Çdo gjë ka një kulm, ndërsa kulmi i Kuranit është surja El-Bekare. Në të ka një ajet që është maja e të gjitha ajeteve të Kuranit dhe ai është ajeti El-Kursij” (Tirmidhi, nr. 2878). Pra, është veçantia e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, të cilit i zbriti kjo sure. El-Bekarja gjithashtu flet rreth çështjeve të namazit, të agjërimin, të zekatit dhe të haxhit. Përmenden në mënyrë të veçantë lutjet e *Hazret* Ibrahim<sup>as</sup> e të *Hazret* Ismailit<sup>as</sup>, të cilat ata i bënë gjatë rindërtimit të Shtëpisë së Allahut.

Po në këtë sure gjejmë edhe besëlidhjen (*mithak-un*), që Zoti e bëri me bijtë e Izraelit, besë të cilën këta të fundit, nga shpirtligësia e tyre, e thyen, gjë që pararendi ardhjen e *Hazret* Isait<sup>as</sup>.

Në fund të kësaj sureje vjen një ajet, i cili duket sikur është përmbledhje e të gjitha lutjeve dhe, në këtë mënyrë, na siguron një thesar të pashtershëm lutjesh.





1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.<sup>1</sup>

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

Xhuzi 1

2. *Elif.Lam.Mim.* (Unë jam Allahu, më i Dijshmi.)<sup>2</sup>

أَلِفْ لَامْ مِيمٌ

3. Ky është Libri. Nuk ka mëdysheje në të. Është udhëzim për ata që kanë druajtje,<sup>3</sup>

ذٰلِكَ الْكِتٰبُ لَا رَيْبَ فِيْهِ هُدًى لِّلْمُتَّقِيْنَ ①

1. Ajeti *Bismil-lahirr-Rrahmanirr-Rrahim* është ajeti i parë i çdo sureje të Kuranit, përveç sures së 9-të (Teube ose Bera'a). Ka një thënie të transmetuar nga Ibni Abasi<sup>ra</sup> që thotë se sa herë që shpallej ndonjë sure e re, shpallja fillonte me *Bismil-lah...*, dhe pa *Bismil-lah...*, i Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> nuk e dinte se kishte filluar një sure e re. (Ebu Davud, nr. 788). Shkurt, ajeti *Bismil-lah...* në fillim të çdo sureje, është vendosur me urdhrin e Allahut. Andaj, në këtë Kuran dhe në të gjithë literaturën e Xhematit Musliman Ahmedia, ky ajet llogaritet si ajeti i parë, jo vetëm i sures El-Fatiha, por i çdo sureje të Kuranit të Shenjtë. Për këtë arsye, lexuesi të ketë parasysh se numrat e ajeteve të sureve të Kuranit, në këtë botim, mund të jenë një më shumë sesa numrat e përmendur të ajeteve në kopje të tjera të Kuranit të Shenjtë.

2. Shkurtesat, si *Elif.Lam.Mim*, njihen si *el-mukatta'at* (shkurtesat) dhe vijnë në fillim të jo më pak se 28 sureve dhe përbëhen nga një ose më shumë, deri në maksimum pesë shkronja të alfabetit arab. *El-mukatta'at* janë shkurtesa që shpalosin atribute të Zotit, njëherësh, edhe disa tema të sures ku ato vijnë. Ato nuk janë vendosur rastësisht në fillim të sureve të ndryshme dhe as shkronjat nuk janë vendosur në mënyrë arbitrare, përkundrazi, ekziston një lidhje e thellë midis tyre. Kurse temat e sureve që nuk kanë shkurtesat, mbartin temat e sureve të mëparshme që i kanë shkurtesat. Nga kuptimet e dhëna për këto shkurtesa, dy duken më autentike: (a) se çdo shkronjë ka një vlerë të caktuar numerike (Shevkaniu, "Fet'hul-Kadir", nën ajetin 2:1); (b) ato përfaqësojnë atributet e Allahut, siç e thamë më sipër, atribute të cilat janë edhe çelësi i kuptimeve të sureve përkatëse. Kështu, një prej kuptimeve të shkurtesave *Elif.Lam.Mim*, sipas Hazret Ibni Abasi<sup>ra</sup>, është *Ene Allahu A'lem*, d.m.th. "*Unë jam Allahu, më i Dijshmi*" (Tefsiri i Bagaviut, nën ajetin 2:1).

3. Ky Libër u sjell dobi atyre të cilët kanë druajtje (*takva*) dhe që pranojnë këshillën. Fjala *takva* në arabisht vjen nga folja *veka*, që do të thotë *shpëtoj, ruhem* etj., por në literaturën fetare kjo fjalë përdoret për të shënuar *ruajtje nga mëkati dhe ligësia*, dhe jo thjesht *frikë*. *Vekaje* i thonë *mburojës*. Dhe besimtari që ka *takvanë* ndaj Zotit, Zotin e merr si mburojë për t'u ruajtur nga mëkati. Kur dikush e pyeti Hazret Ebu Hurejren<sup>ra</sup> se çfarë është *takvaja*, ai i tha – çfarë bën kur kalon nëpër ferra? – Kaloj duke iu ruajtur gjembave – iu përgjigj pyetësi. – Kjo pikërisht është *takvaja*, tha ai (Bejhaki, nr. 963). Pra, *takva* do të thotë të ruhesh nga çdo mëkat, sado i vogël qoftë. Shkalla më e vogël e druajtjes është ajo kur njeriu tregohet i gatshëm të dëgjojë të vërtetën, pa pasur paragjykimë. Pra, kur një jomusliman fiton druajtje, atij i largohen mendjemadhësia, dukja dhe paragjykimi. Këto janë errësira që nuk e lejojnë

4. që besojnë në të padukshmen, falin namazin<sup>4</sup> dhe shpenzojnë nga çdo gjë që Ne u kemi dhënë;

الَّذِينَ يُؤْمِنُونَ بِالْغَيْبِ وَيُقِيمُونَ الصَّلَاةَ  
وَمَا رَزَقْنَاهُمْ يُنْفِقُونَ ﴿٤﴾

5. që besojnë në atë që të është shpallur ty dhe në atë që është shpallur para teje dhe edhe *ahiretin*<sup>5</sup> e besojnë bindshëm.

وَالَّذِينَ يُؤْمِنُونَ بِمَا أُنزِلَ إِلَيْكَ وَمَا  
أُنزِلَ مِنْ قَبْلِكَ ۖ وَالْآخِرَةَ هُمْ  
يُوقِنُونَ ﴿٥﴾

6. Pikërisht këta janë në udhëzim prej Zotit të tyre dhe pikërisht këta janë të suksesshmit.<sup>6</sup>

أُولَئِكَ عَلَىٰ هُدًى مِنْ رَبِّهِمْ ۗ وَأُولَئِكَ  
هُمُ الْمُفْلِحُونَ ﴿٦﴾

dritën Hyjnore të depërtojë në shpirtin e njeriut.

4. Fjalët e Kuranit për faljen e namazit janë *ikametus-salah*, që fjalë për fjalë do të thotë *ngre a lartësoj namazin*. Në të gjithë Kuranin e Shenjtë veprimi i kryerjes së namazit përmendet me foljen *lartësoj*, që do të thotë që duhet të përpiqesh ta mbash namazin në lartësinë e duhur dhe nuk duhet të lejosh që të të bjerë. Rituali i namazit është shprehja e jashtme fizike që përkthen ndjenjat dhe lidhjen tënde me Zotin. Përveç kësaj, nga mirësitë e Zotit përfiton si trupi, ashtu edhe shpirti. Andaj, adhurimi i përkryer do të ishte pikërisht ai që do t'i përfshinte të dyja anët, edhe truporen, edhe shpirtëroren, siç me të vërtetë është falja islame që quhet *salah* ose *namaz*. Pa adhurim të sinqertë të shpirtit, namazi fizik është si një lëvozhgë pa bërthamë. Por edhe lëvozhga është e nevojshme që ta ruajë e ta zhvillojë bërthamën. Të dyja plotësojnë njëra-tjetrën. Dhe ruajtja e të dyja anëve nga namazfalësi është *lartësimi i namazit*, togfjalësh të cilin, në shqip, e kemi përkthyer siç përkthehet zakonisht nga të gjithë shqipfolësit muslimanë, pra *falja* ose *kryerja e namazit*.

5. *Ahiret*, fjalë për fjalë do të thotë *e mëvonshme* dhe shpesh i referohet jetës që do të vijë pas jetës së kësaj bote, megjithatë, në Kuran kjo fjalë është përdorur jo pak herë edhe në kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalës.

6. Këto ajete ndër të tjera përmendin katër kritere, të cilat janë domosdoshmëri për një send që të quhet i përsosur, qoftë ai libër: 1) kriteri autorial, 2) kriteri material, 3) kriteri strukturor dhe 4) kriteri objektiv-kulminant. Shkurtesat *Elif.Lam.Mim* tregojnë përsosmërinë e Kuranit për sa i përket kriterit autorial, pra, thotë: “*Unë jam Allahu, më i Dijshmi*”. Kriteri material i Kuranit është në fjalët “*Ky është Libri*”, domethënë, ky libër buron prej Zotit që di më shumë se të gjithë. Emri *libër* duke qenë në trajtën e shquar gjithashtu nënkupton se ky është ai Libër i shumëpritur, shpallja e të cilit ishte e parashikuar në Librat e shenjtë të mëparshëm. Kriteri strukturor i Kuranit është ai që përmendet në fjalët “*nuk ka dyshim në të*”. Çdo fjalë e tij është e qëndrueshme dhe çdo pohim që bën ai është i argumentuar dhe i qartë. Pastaj, kriteri objektiv-kulminant, d.m.th. çfarë ndikimi bën ky Libër, përmendet në fjalët: “*Është udhëzim për ata që kanë drujtje*”, pra që kanë frikë dhe turp të mëkatojnë dhe ta refuzojnë të vërtetën. Pasi i përmend këto katër kritere, Kurani tregon vetitë më të hollësishme të atyre që kanë këtë drujtje, dhe sqaron se kush janë ata, që do të udhëzohen.

7. Pa dyshim, ata që mohojnë, (saqë) njëlloj është sikur t'i paralajmërosh a të mos i paralajmërosh, nuk do të besojnë.

إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا سَوَاءٌ عَلَيْهِمْ ءَأَنْذَرْتَهُمْ  
أَمْ لَمْ تُنذِرْهُمْ لَا يُؤْمِنُونَ ﴿٧﴾

8. Allahu ua vulosi zemrat dhe dëgjimin, dhe mbi sytë e tyre ka perde. Për ta është ndëshkim i madh.<sup>7</sup>

خَتَمَ اللَّهُ عَلَى قُلُوبِهِمْ وَعَلَى سَمْعِهِمْ  
وَعَلَى أَبْصَارِهِمْ غِشَاوَةٌ ۖ وَ لَهُمْ عَذَابٌ  
عَظِيمٌ ﴿٨﴾

9. Ka njerëz që thonë: “Besojmë në Allah dhe në Ditën e Fundit”, por ata nuk janë besimtarë.

وَمِنَ النَّاسِ مَنْ يَقُولُ آمَنَّا بِاللَّهِ وَ يَوْمَئِذٍ  
أَلَّا نَحْنُ بِمُؤْمِنِينَ ﴿٩﴾

10. Ata përpiqen të mashtrojnë Allahun dhe besimtarët. Në të vërtetë, ata nuk mashtrojnë askënd tjetër përveç vetvetes, por nuk ndërgjegjësohen.

يُحَدِّثُونَ اللَّهَ وَ الَّذِينَ آمَنُوا ۖ وَ مَا يَحْدَعُونَ  
إِلَّا أَنفُسَهُمْ ۖ وَ مَا يَشْعُرُونَ ﴿١٠﴾

11. Në zemrat e tyre ka një sëmundje, andaj Allahu ua shtoi sëmundjen.<sup>8</sup>

فِي قُلُوبِهِمْ مَرَضٌ ۖ فَزَادَهُمُ اللَّهُ مَرَضًا

7. Kurani i Shenjtë qartazi ka shpjeguar se kjo vulosje në zemrën e njeriut që ia bën Zoti, shkaktohet nga veprat e njeriut, sepse kur njeriu bën një veprim të caktuar, edhe ligji i Zotit vepron duke shkaktuar rezultatin e veprimit të njeriut. Duke përmendur shkaqet e një vulosjeje të tillë, në një ajet tjetër thuhet: “Por kur ata bënë shtrembëri, Allahu ua shtrembëroi zemrat...” (61:6). Kjo pikërisht quhet *vulosje në zemër*. Por Zoti ynë nuk është i tillë që të mos ia heq këtë vulosje, përkundrazi, Ai ka treguar në Kuran edhe metodën, të cilën duke e përdorur, njeriu mund ta largojë këtë damkë, siç thotë: “(dijeni) se ndaj atyre që pendohen, Ai është shumë Falës” (17:26; 3:87-90). Përveç kësaj, organet që njeriu nuk i përdor për një kohë të gjatë, ose i keqpërdor, dalin jashtë funksionit. Mohuesit që përmenden këtu, kur u ballafaquan me të vërtetën, kanë refuzuar t’i vënë në funksion zemrat, dëgjimin dhe shikimin e tyre, rrjedhimisht i kanë humbur këto aftësi.

8. Kur njeriu i vjen sprova ose fatkeqësia, ajo e zhvesh atë. “Sëmundja” që ai e ka të fshehur në zemër, del në pah, dhe e shkatërron atë. Përveç kësaj, është praktika e Zotit që Ai nxjerr vetitë ose veset e fshehura të njeriut. Ai që ka ndonjë dritë në zemrën e tij, Allahu ia zbardh atë duke nxjerrë në pah sinqeritetin e tij. Kurse ai që ka pandershmëri dhe ligësi në zemër, edhe atë ia nxjerr sheshit. Andaj, jeta hipokrite është e mallkuar dhe nuk mund të mbetet e fshehtë, dhe kur del në shesh, e poshtëron njeriun që bën një jetë të tillë. Kështu, i Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> bëri një ftesë shpirtërore. Disa e pranuan, kurse disa të tjerë e refuzuan. Profetët pikërisht në këtë mënyrë ua zbulojnë njerëzve fatmirësinë ose ligësinë e tyre.

Ata do të kenë dënim të dhimbshëm, për shkak se gënjenin.

وَلَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ<sup>٩</sup> بِمَا كَانُوا يَكْذِبُونَ<sup>٩</sup>

12. E kur u thuhet: “Mos bëni ngatërresa në tokë!”, ata thonë “Jemi vetëm përmirësues”.

وَإِذَا قِيلَ لَهُمْ لَا تُفْسِدُوا فِي الْأَرْضِ قَالُوا إِنَّمَا نَحْنُ مُصْلِحُونَ<sup>١٠</sup>

13. Dijeni! Pikërisht ata janë ngatërrëstarët, por nuk ndërgjegjësohen.

أَلَا إِنَّهُمْ هُمُ الْمُفْسِدُونَ وَلَكِن لَّا يَشْعُرُونَ<sup>١١</sup>

14. E kur u thuhet: “Besoni ashtu siç besuan njerëzit (besimtarë)”, ata thonë: “A të besojmë ashtu siç besuan mendjelehtët?” Dijeni! Vetë ata janë mendjelehtët, por nuk e dinë.

وَإِذَا قِيلَ لَهُمْ آمِنُوا كَمَا آمَنَ النَّاسُ قَالُوا أَنُؤْمِنُ كَمَا آمَنَ السُّفَهَاءُ<sup>١٢</sup> أَلَا إِنَّهُمْ هُمُ السُّفَهَاءُ وَلَكِن لَّا يَعْلَمُونَ<sup>١٢</sup>

15. Dhe kur takohen me ata që besuan, u thonë: “Ne besuam”, ndërsa kur rrinë vetëm me djajtë e tyre,<sup>9</sup> u thonë: “Në të vërtetë jemi me ju; ne thjesht po talleshim”.

وَإِذَا لَقُوا الَّذِينَ آمَنُوا قَالُوا آمَنَّا وَإِذَا خَلَوْا إِلَىٰ شِيَاطِينِهِمْ قَالُوا إِنَّا مَعَكُمْ إِنَّمَا نَحْنُ مُسْتَهْزِءُونَ<sup>١٣</sup>

16. Allahu do t'i përgjigjet talljes së tyre dhe do t'i lërë për një kohë që të vërtiten në tërbimin e tyre.

اللَّهُ يَسْتَهْزِئُ بِهِمْ وَيَمُدُّهُمْ فِي طُغْيَانِهِمْ يَعْمَهُونَ<sup>١٤</sup>

17. Pikërisht këta kanë këmbyer udhëzimin me devijimin. Prandaj, tregtia e tyre nuk u solli fitimin, as ata nuk arritën të bëheshin të udhëzuar.

أُولَٰئِكَ الَّذِينَ اشْتَرُوا الضَّلَالَةَ بِالْهُدَىٰ فَمَا رَبِحَتْ تِجَارَتُهُمْ وَمَا كَانُوا مُهْتَدِينَ<sup>١٥</sup>

18. Shembulli i tyre është si ata që ndezën zjarr,<sup>10</sup> dhe kur ai ua ndriçoi

مَثَلُهُمْ كَمَثَلِ الَّذِي اسْتَوْقَدَ نَارًا<sup>١٦</sup> فَلَمَّا

9. Fjala *shejātīn* që vjen në këtë ajet, është shumësi i fjalës *shejtan*, që do të thotë *çdo rebel dhe shkelës i kufijve*. Po kështu, nisur nga tema e saj, kjo fjalë i referohet edhe atij që *largohet* (Akrab). Andaj, *shejātīn* në këtë ajet nënkuptojnë ata hipokritë të mëdhenj, të cilët i largohen së vërtetës dhe tentojnë t'i largojnë edhe të tjerët.

10. Në arabisht fjala *nar* (zjarr) përdoret edhe për luftën. Andaj, një ndër kuptimet e ajetit është që hipokritët ndezën luftë që muslimanët të ndesheshin me mohuesit, por kur lufta u

atë që ishte përreth, Allahu ua mori dritën dhe i la në errësira që ata të mos shohin asgjë;

أَصَابَتْ مَا حَوْلَهُ ذَهَبَ اللَّهُ بِنُورِهِمْ  
وَتَرَكَّهُمْ فِي ظُلْمَةٍ لَا يُبْصِرُونَ ﴿١٨﴾

19. ata janë të shurdhër, memecë, të verbër, prandaj nuk kthehen;

صُمُّوا بِكُمْ عَمَىٰ فَهُمْ لَا يَرْجِعُونَ ﴿١٩﴾

20. ose është si shtrëngata që bie prej qiellit, në të cilën ka errësira, bubullimë dhe vetëtimë. Ata mbyllin veshët me gishtat e tyre për shkak të gjëmimeve nga frika e vdekjes. Allahu i rrethon mohuesit.<sup>11</sup>

أَوْ كَصَيْبٍ مِّنَ السَّمَاءِ فِيهِ ظُلُمَةٌ وَرَعْدٌ  
وَبَرْقٌ ۖ يَجْعَلُونَ أَصَابِعَهُمْ فِي آذَانِهِمْ مِّنَ  
الصَّوَاعِقِ حُدَرَ الْمَوْتِ ۗ وَاللَّهُ مُجِيبٌ  
بِالْكَافِرِينَ ﴿٢٠﴾

21. Vetëtima gati ua rrëmben shikimin. Sa herë që ajo u bën dritë, ata ecin në të; kur u fiket, ndalen. Po të dojë Allahu, mund t'ua marrë edhe dëgjimin, edhe shikimin.<sup>12</sup> Sigurisht, Allahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë.<sup>13</sup>

يَكَادُ الْبَرْقُ يَحْطِفُ أَبْصَارَهُمْ ۗ كُلَّمَا  
أَصَابَهُمْ مَّثَوْا فِيهِ ۗ وَإِذَا أَظْلَمَ  
عَلَيْهِمْ قَامُوا ۗ وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ لَذَهَبَ  
بِسَمْعِهِمْ وَأَبْصَارِهِمْ ۗ إِنَّ اللَّهَ عَلَىٰ كُلِّ  
شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿٢١﴾

përhap, e pësuan hipokritët. Muslimanët fituan, kurse hipokritët Allahu i Madhërishtëm i la pa rrugëdalje. Rrjedhimisht, u çorientuan dhe si të verbuar zunë të kalonin sa andej e këtej.

11. Ky dhe ajetet paraardhëse u referohen dy kategorive të hipokritëve: (1) jobesimtarët që u paraqitën si muslimanë; dhe (2) besimtarët që kanë qenë të dobët si në besim, ashtu edhe në vepra, dhe si të tillë, ishin të prirë kah mosbesimi. Ky ajet duket se pasqyron gjendjen e grupit të dytë të hipokritëve, të cilët tremben thjesht me një “shi” të vogël me “bubullima” e “vetëtima”, dhe nuk arrijnë të përfitojnë prej tij. Lexoni edhe shpjegimin e ajetit vijues.

12. Hipokritët, të përshkruar si besimtarë të dobët, janë shumë afër humbjes së shikimit shpirtëror. Ata në fakt nuk e kanë humbur atë, por nëse ballafaqohen vazhdimisht me situata që kërkojnë guxim e sakrificë, që u duken si rufeja e bubullima, ka shumë të ngjarë ta humbasin atë, pra, besimin e tyre. Por mëshira e Zotit është e tillë që vetëtima jo çdoherë shoqërohet me bubullimë. Shpesh ajo është vetëm një blic i fortë, i cili e ndihmon udhëtarin të ecë përpara gjatë natës. Pra, hipokritët e tillë kur shohin se Islami po përparon, kontribuojnë dhe bashkëpunojnë me besimtarët e tjerë. Por kur vetëtima shoqërohet me bubullima, d.m.th. kur situata kërkon sakrificën e jetës ose të pasurisë, atyre u errën sytë dhe ata mbeten të shtangur, duke refuzuar të vazhdojnë me besimtarët.

13. Në Kuranin e Shenjtë, fjalia e fundit e këtij ajeti përsëritet shpesh, të cilën disa njerëz e kritikojnë duke ngritur pyetjet si: “Zoti, derisa thotë se është i Plotfuqishëm të bëjë çdo gjë, a mund të bëhet njeri, a mund të vdesë, etj. etj.?” Ma’adhallah! Por vetë kjo fjali e ka edhe përgjigjen. Fjala *shej’un* (çdo gjë), sipas gramatikës arabe mund të jetë edhe *ism* (emër), edhe

22. O njerëz! Adhuroni Zotin tuaj që ju krijoi ju dhe ata që ishin para jush, në mënyrë që të keni druajtje.

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اعْبُدُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ  
وَالَّذِينَ مِنْ قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ ﴿٢٢﴾

23. (Ai) që krijoi për ju tokën si shtrat, qiellin si bazë (të mbijetesës suaj) dhe prej qiellit zbriti ujë dhe nëpërmjet tij nxori fruta të çdollojshme si ushqim për ju. Prandaj, mos i bëni ortakë Allahut me vetëdije.

الَّذِي جَعَلَ لَكُمْ الْأَرْضَ فِرَاشًا وَالسَّمَاءَ  
بِنَاءً ۗ وَأَنْزَلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَأَخْرَجَ بِهِ  
مِنَ الشَّجَرَاتِ رِزْقًا لَكُمْ ۗ فَلَا تَجْعَلُوا لِلَّهِ  
أَنْدَادًا وَأَنْتُمْ تَعْلَمُونَ ﴿٢٣﴾

24. E nëse jeni në mëdyshje për atë që kemi zbritur mbi robin Tonë, sillni ndonjë sure të tillë dhe thirrni edhe ndihmësit tuaj (që keni përcaktuar) duke e lënë Allahun, po që se jeni të vërtetë.<sup>14</sup>

وَإِنْ كُنْتُمْ فِي رَيْبٍ مِمَّا نَزَّلْنَا عَلَى  
عَبْدِنَا فَاتَّبُوا لِسُورَةٍ مِنْ مِثْلِهِ ۗ وَادْعُوا  
شُهَدَاءَكُمْ مِنْ دُونِ اللَّهِ إِنْ كُنْتُمْ  
صَادِقِينَ ﴿٢٤﴾

25. Por nëse nuk e bëni këtë, dhe patjetër që nuk do të arrini ta bëni, frikësojuni zjarrit, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët.<sup>15</sup> Ai është përgatitur për mohuesit.

فَإِنْ لَّمْ تَفْعَلُوا وَلَنْ تَفْعَلُوا فَاتَّقُوا النَّارَ  
الَّتِي وَقُودُهَا النَّاسُ وَالْحِجَارَةُ ۗ أَعَدَّتْ  
لِلْكَافِرِينَ ﴿٢٥﴾

*masdar* (paskajore) e foljes *sha'a* (dëshiroj); *masdar* (paskajore) në gjuhën arabe përdoret edhe si *fa'il* (veprues), edhe si *mef'ul* (objekti mbi të cilin bie veprimi), dhe në këtë ajet, fjala *shej'un* është edhe si objekt. Andaj, kuptimi i plotë i kësaj fjalie është: “Sigurisht, Allahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë që *dëshiron*”.

14. Në Kuranin e Shenjtë, në disa ajete përmendet sfida për të sjellë një sure, në disa ajete të tjera sfida për dhjetë sure e në të tjera edhe për gjithë Kuranin. Në këtë ajet Kurani sfidon njeriun të sjellë një sure të tillë. Mund të bëhet fjalë pikërisht për suren El-Bekare. Kjo tregon se kjo sure e vetme trajton përmbledhtas të gjitha çështjet e Kuranit. Ndërsa aty ku përmendet sfida për të sjellë dhjetë sure, nënkuptohen dhjetë sure të Kuranit, qofshin sure të shkurtra që vijnë në pjesën e fundit apo të gjata, shembull të të cilave njeriu nuk do të mund të sjellë. Për sa i përket sfidës për të sjellë shembull të të gjithë Kuranit, as nuk bëhet fjalë që mund ta realizojë njeriu.

15. *Lënda djegëse* mund të jetë në kuptimin figurativ, që do të thotë se dënimi i xhehenemit shkaktohet nga adhurimi i idhujve. Pra, idhujt janë si lëndë djegëse për zjarrin e ferrit, pasi, përveç njerëzve të këqij, edhe ata u bëjnë mjete për ngritjen e xhehenemit. Ose, *gurët* nënkuptojnë idhujt që janë të pajetë, të cilët idhujtarët i adhurojnë si zota, dhe ideja është se idhujtarët do të poshtërohen duke dëshmuar se zotat e tyre do të hidhen në zjarr dhe pikërisht ata do t'ua ndezin zjarrin e xhehenemit.

26. Dhe jepu lajm të gëzueshëm atyre që besuan dhe bënë të mira, që për ta ka kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Kurdoherë që do t'u jepet ndonjë frutë prej tyre si ushqim, ata do të thonë: “Kjo është ajo që na ishte dhënë edhe më parë!” Por atyre u ishte dhënë (ushqim) i ngjashëm me të.<sup>16</sup> Gjithashtu, në to do të kenë bashkëshortë<sup>17</sup> të dëlirë dhe atje do të jetojnë përgjithmonë.

وَبَشِّرِ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ أَنَّ لَهُمْ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ كُلَّمَا رُزِقُوا مِنْهَا مِنْ ثَمَرَةٍ رِزْقًا قَالُوا هَذَا الَّذِي رُزِقْنَا مِنْ قَبْلُ وَأَنْتُوا بِه مُتَشَابِهًا وَلَهُمْ فِيهَا أَرْوَاحٌ مُطَهَّرَةٌ وَهُمْ فِيهَا خَالِدُونَ ﴿١٦﴾

27. Allahut nuk i vjen turp për të paraqitur çfarëdolloj shembulli, as atë të mushkonjës, madje as të asaj që gjendet mbi të.<sup>18</sup> Ata që besuan, e dinë se ai pa dyshim është i vërtetë (dhe vjen) prej Zotit të tyre. Ndërsa mohuesit thonë: “Çfarë deshi Allahu

إِنَّ اللَّهَ لَا يَسْتَحْيِي أَنْ يَضْرِبَ مَثَلًا مَّا بَعُوضَةً فَمَا فَوْقَهَا فَأَمَّا الَّذِينَ آمَنُوا فَيَعْلَمُونَ أَنَّهُ الْحَقُّ مِنْ رَبِّهِمْ ؕ وَأَمَّا الَّذِينَ كَفَرُوا فَيَقُولُونَ مَاذَا أَرَادَ اللَّهُ

16. Në këtë ajet, Zoti i Madhërishëm shëmbëlleu besimin me kopshtin, nëpër të cilin rrjedhin lumenj. Duke dhënë një filozofi shumë të lartë, Zoti në këtë shembull na tregoi që të njëjtën lidhje që kanë lumenjtë me kopshtin, kanë edhe veprat me besimin. Ashtu siç një kopsht nuk mund të gjelbërojë pa vaditje, në të njëjtën mënyrë, besimi nuk mund të qëndrojë pa veprat e mira. Nëse ka besim dhe mungojnë veprat, ai besim është i pavlerë. Dhe nëse ka vepra dhe nuk ka besim, ato vepra janë dukje. E vërteta që tregon Islami është që xheneti është një pasqyrë e besimit dhe e veprave të kësaj bote dhe jo diçka e huaj për njeriun. Pra, xheneti i njeriut buron po prej njeriut. Xheneti është pikërisht besimi dhe veprat e mira të tij. Atë ai fillon ta shijojë që në këtë botë dhe, në një mënyrë të fshehtë, që këtu atij fillojnë t'i duken kopshtet e besimit dhe lumenjtë e veprave të mira. Në botën vijuese këto kopshte do t'i duken hapur. Mësimi i shenjtë i Zotit na udhëzon se besimi i pastër, i palëkundur dhe i përsosur në Zot, në atributet dhe në punët e Tij, është si një kopsht (xhenet) i bukur me plot pemë e fruta, dhe veprat e mira janë si lumenj që e vadin kopshtin. Lexoni edhe 32:18; 47:16.

17. Fjala *ezvaxhun* (çifte) nënkupton se xhenetlinjtë do të jetojnë në çifte, që atyre t'u përsoset zhvillimi dhe ata ta gëzojnë prehjen. Sipas Kuranit të Shenjtë, çdo gjë përveç Zotit, ka nevojë për çift. Sipas këtij ligji, edhe banorëve të xhenetit, qofshin burra, qofshin gra, do t'u nevojitet të jenë në çift. Mbetet pyetja se çfarë lloji çiftesh do të jenë, këtë e di Allahu i Madhërishëm, kurse njeriu do ta dijë atë kur të jetë pjesë e xhenetit.

18. Një kuptim i fjalëve “*ajo që është mbi të*” është *ajo që e mbart mushkonja*, dhe kjo mund t'u referohet edhe mikrobeve që shkaktojnë malarien dhe sëmundje të tjera. Në botë njerëz të panumërt vdesin nga malaria dhe nga sëmundjet që shkaktohen prej saj. “*Allahut nuk i vjen turp*” do të thotë se nuk ka nevojë t'i vijë turp për të dhënë një shembull të tillë, pasi është një shembull i goditur.

me këtë shembull?” Ai devijon shumëkënd me anë të tij dhe, po me anë të tij, udhëzon shumëkënd. Me anë të tij, Ai nuk devijon askënd tjetër përveç të ligjeve.

28. Të cilët thyejnë besën me Allahun pasi e kishin lidhur fort, shkëpusin (lidhjen) që Allahu i kishte porositur ta mbanin dhe bëjnë çrregullime në tokë. Pikërisht këta janë humbësit.

29. Si mund ta mohoni Allahun, ndërkohë që ju ishit të vdekur dhe Ai ju dha jetë?! Ai sërish do t’ju japë vdekje, sërish do t’ju japë jetë (dhe) pastaj tek Ai do të ktheheni.

30. Është Ai që krijoi për ju gjithçka që gjendet në tokë, më pas iu drejtua qiellit dhe e rregulloi në shtatë qiej.<sup>19</sup> Ai është i Gjithëdijshëm për çdo gjë.

31. Dhe kur Zoti yt u tha engjëjve: “Unë do të vë një mëkëmbës në tokë”, ata thanë: “A do të vësh dikë që do të bëjë çrregullime në të dhe do të derdhë gjak, ndërkohë që ne të përkujtojmë Ty me lavdërimin Tënd dhe përmendim shenjtërinë Tënde?” Ai tha: “Unë e di atë që ju nuk e dini”.<sup>20</sup>

19. Nuk do të thotë se Zoti së pari e krijoi Tokën e pastaj krijoi hapësirën dhe trupat qiellorë, pasi ky ajet nuk flet për krijimin e universit lëndor. Ajeti tërheq vëmendjen te krijimi i universit shpirtëror, duke na informuar për shtatë shkallë jashtëzakonisht të mëdha të zhvillimit shpirtëror të njeriut. Andaj, menjëherë pas këtij ajeti, Kurani na kujton episodin e parë të këtij lartësimi shpirtëror që fillon me *Hazret Ademin*<sup>as</sup>.

20. Engjëjt nuk e kundërshtuan qëllimin e Zotit dhe as nuk pretenduan epërsi ndaj Ademit. Pyetja e tyre erdhi pasi u njohën me shpalljen e Zotit, me planin e Tij, për të caktuar një

بِهَذَا مَثَلًا يُضِلُّ بِهِ كَثِيرًا وَيَهْدِي بِهِ  
كَثِيرًا وَمَا يُضِلُّ بِهِ إِلَّا الْفَاسِقِينَ ﴿٢٧﴾

الَّذِينَ يَتَّقُونَ عَهْدَ اللَّهِ مِنْ بَعْدِ مِيثَاقِهِ  
وَيَقْطَعُونَ مَا أَمَرَ اللَّهُ بِهِ أَنْ يُوصَلَ  
وَيُفْسِدُونَ فِي الْأَرْضِ ۗ أُولَٰئِكَ هُمُ  
الْخٰسِرُونَ ﴿٢٨﴾

كَيْفَ تَكْفُرُونَ بِاللَّهِ وَكُنْتُمْ أَمْوَاتًا  
فَأَحْيَاكُمْ ۗ ثُمَّ يُمِيتُكُمْ ثُمَّ يُحْيِيكُمْ ثُمَّ  
إِلَيْهِ تُرْجَعُونَ ﴿٢٩﴾

هُوَ الَّذِي خَلَقَ لَكُمْ مَا فِي الْأَرْضِ جَمِيعًا  
ثُمَّ اسْتَوَىٰ إِلَى السَّمَاءِ فَسَوَّاهُنَّ سَبْعَ  
سَمَوَاتٍ ۗ وَهُوَ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ ﴿٣٠﴾

وَإِذْ قَالَ رَبُّكَ لِلْمَلَائِكَةِ إِنِّي جَاعِلٌ فِي  
الْأَرْضِ خَلِيفَةً ۗ قَالُوا أَتَجْعَلُ فِيهَا مَنْ يُفْسِدُ  
فِيهَا وَيَسْفِكُ الدِّمَاءَ ۗ وَنَحْنُ نُسَبِّحُ بِحَمْدِكَ  
وَنُقَدِّسُ لَكَ ۗ قَالَ إِنِّي أَعْلَمُ مَا  
لَا تَعْلَمُونَ ﴿٣١﴾



32. Ai ia mësoi Ademit<sup>21</sup> të gjithë emrat e më pas ua paraqiti ato (krijesa) engjëjve dhe u tha: “Më tregoni emrat e tyre, po qe se e thoni të vërtetën!”<sup>22</sup>

وَعَلَّمَ آدَمَ الْأَسْمَاءَ كُلَّهَا ثُمَّ عَرَضَهُمْ عَلَى الْمَلَائِكَةِ فَقَالَ أَنْبِئُونِي بِأَسْمَاءِ هَؤُلَاءِ  
إِنْ كُنْتُمْ صَادِقِينَ ﴿٣١﴾

33. Ata thanë: “I Shenjtë je Ti.<sup>23</sup> Nuk kemi aspak dije, përveç asaj që Ti

قَالُوا سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَا إِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا

mëkëmbës (*kalif*). Mëkëmbësi nevojitet atëherë kur duhet të ruhet rendi dhe të zbatohet ligji. Padakortësia, në dukje, e engjëjve nënkuptonte se do të kishte njerëz në tokë që do ta shkëlpin ligjin, që do të bënin rregullime dhe do të derdhnin gjak. Njeriu do të ishte i pajisur me fuqi të mëdha për të bërë të mirën dhe të keqen, dhe engjëjt folën për anën më të errët të karakterit të tij, por Zoti e dinte se po ky njeri mund të ngrihej në lartësi të tilla morale, sa të bëhej pasqyra e attributeve Hyjnore, duke i parakaluar edhe engjëjt. Siç përmendet në udhëtimin e *Miraxhit*, kur në një pikë edhe krye-engjëlli Xhibrail<sup>as</sup> i kërkoi Profetit ta vijonte udhëtimin vetëm, pasi më andej as ai nuk mund të shkonte dot. Është interesante që historia e *Hazret Ademit*<sup>as</sup> në Kuranin e Shenjtë fillon me fjalët “*Dhe kur Zoti yt u tha engjëjve...*”, pra, duke iu drejtuar Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, gjë që tregon se nuk ishte vetëm *Hazret Ademi*<sup>as</sup> qëllimi i gjithë këtij plani Hyjnor, por të gjithë të Dërguarit e Zotit që do të vinin njëri pas tjetrit dhe kulmi i tyre do të ishte pikërisht Profeti Muhammed<sup>savs</sup>. Kësaj ane të ndritshme të karakterit njerëzor i referohen fjalët “*Unë e di atë që ju nuk e dini*”.

21. Ademi<sup>as</sup> që jetoi rreth 6000 vjet më parë, besohet nga shumë njerëz se është njeriu i parë i krijuar nga Zoti në planetin e Tokës. Megjithatë, kjo pikëpamje nuk vërtetohet nga Kurani. Bota ka kaluar nëpër cikle të ndryshme krijimi e qytetërimi, dhe Ademi<sup>as</sup>, paraardhësi i racës së tanishme njerëzore, është vetëm lidhja e parë në ciklin e tanishëm, dhe jo njeriu i parë në krijimin e Zotit. Është thënë shumë për vendin ku lindi *Hazret Ademi*<sup>as</sup> ose ku u rrit si Profet. Mendimi popullor është se ai u vendos në xhenet (jashtë Tokës), por më vonë u dëbua prej tij dhe u vendos diku në Tokë. Fjalët e këtij ajeti “në tokë”, e hedhin poshtë këtë pikëpamje, madje vërtetojnë se *Hazret Ademi*<sup>as</sup> jetoi në Tokë dhe po këtu Allahu e ngriti si Kalif, pra profet të Tij. Kështu, ai ishte Profeti i parë i njerëzimit. Lexoni edhe 7:12.

22. Fjala *emrat* mund t’u referohet shumë gjërave, për shembull: (1) realiteteve të sendeve, (2) emrave të gjuhës arabe, (3) attributeve që nuk kishin engjëjt, (4) emrave të Profetëve që do të lindnin nga soji i Ademit. Engjëjt nuk i dinin këta emra dhe kur Ademi ua përmendi, ata u befasuan. Ideja e engjëjve që “*ai do të derdhë gjak*” duket e vërtetë në lidhje me ardhjen e Profetëve, por jo sipas vështrimit të engjëjve. Ata e dinin se nëse do të caktohej ndonjë mëkëmbës i Zotit në tokë, do të derdhej gjak, por nuk e dinin se kjo nuk do të ndodhte për fajin e Profetit, por për fajin e kundërshtarëve të tij. Një kuptim tjetër është që Zoti e njohu me Emrat e Vetë që quhen *esmaul-husna* (59:25), pasi engjëjt nuk mund t’i ndiqnin shumë nga atributet e Zotit, kurse njeriu po, dhe si i tillë ai bëhet mëkëmbës i Tij në tokë. Pra, engjëjt janë një krijesë që nuk kanë vullnet të lirë dhe ata bëjnë vetëm atë që u urdhërohet (66:7), kurse njeriu ka lirinë e zgjedhjes, gjë që e bën të mundur t’i pasqyrojë emrat ose atributet e Zotit më shumë sesa engjëjt (lexoni edhe 2:31). Shkurt, Zoti së pari i dha Ademit lirinë e zgjedhjes dhe kapacitetet e nevojshme për t’u njohur me emrat e Zotit, e më pas i dha edhe dijen rreth emrave të Tij dhe e udhëzoi.

23. Për fjalët *subhaneke* (i Shenjtë je Ti), lexoni 57:2.

na mësove. Pa dyshim, vetëm Ti je i Gjithëdijshmi, i Urti”.

إِنَّكَ أَنْتَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ ﴿٣٣﴾

34. Ai tha: “O Adem! Tregoj emrat e tyre”. Kur ai ua tregoi emrat e tyre, (Allahu) u tha: “A nuk ju thashë se Unë me të vërtetë e di të padukshmen e qiejve e të tokës dhe e di edhe atë që shfaqni, edhe atë që fshihni?!”

قَالَ يَا أَدَمُ أَخْبِرْهُمْ بِأَسْمَائِهِمْ ۖ فَلَمَّا أَخْبَاهُمْ بِأَسْمَائِهِمْ ۙ قَالَ أَلَمْ أَقُلْ لَكُمْ إِنِّي أَعْلَمُ غَيْبَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ۙ وَأَعْلَمُ مَا تُبْدُونَ وَمَا كُنْتُمْ تَكْتُمُونَ ﴿٣٤﴾

35. Dhe kur u thamë engjëjve: “Bëni sexhde për Ademin”, ata të gjithë u përlulën në sexhde, përveç Iblisit.<sup>24</sup> Ai e refuzoi, u tregua mendjemadh dhe ishte ndër mohuesit.

وَإِذْ قُلْنَا لِلْمَلَائِكَةِ اسْجُدُوا لِآدَمَ فَسَجَدُوا إِلَّا إِبْلِيسَ ۖ أَبَىٰ وَاسْتَكْبَرَ ۗ وَكَانَ مِنَ الْكَافِرِينَ ﴿٣٥﴾

36. I thamë Ademit: “Qëndro ti dhe gruaja jote në xhenet<sup>25</sup> dhe nga ai hani lirisht çfarë të doni, por mos iu afroni kësaj peme,<sup>26</sup> përndryshe do të

وَقُلْنَا يَا أَدَمُ اسْكُنْ أَنْتَ وَزَوْجُكَ الْجَنَّةَ وَكُلَا مِنْهَا رَغَدًا حَيْثُ شِئْتُمَا ۖ وَلَا تَقْرَبَا

24. Nuk do të thotë se *iblisi* (djalli) të ketë qenë prej engjëjve. Arabët e përdorin këtë mënyrë të të përjashtuarit, ku të dy emrat në fjali vijë nga lloje të ndryshme. Po kështu, Kurani e shpjegoi diku tjetër se “ai ishte prej xhindëve” (18:51). Engjëjt janë qenie shumë të pastra, kurse djalli është një lloj tërësisht tjetër. Engjëjt dhe djalli janë qenie të mistershme dhe njeriut i është dhënë shumë pak dije në lidhje me to. Andaj, ne si besimtarë besojmë gjithçka që Zoti na informon në lidhje me to. Lexoni edhe 7:23.

25. Fjala *xhenet* (pemishte a kopsht) që gjendet në këtë ajet nuk i referohet paradysës jashtë planetit të Tokës, por një vendi ideal që u quajt paradysë për shkak të papranisë së ligësive, një vend që Allahu caktoi për Profetin Adem<sup>as</sup> dhe pasuesit e tij për të jetuar lirshëm. Këtu fjala *xhenet* nuk mund t’i referohet qiellit sepse: së pari, Kurani deklaroi qysh në fillim që Ademi u krijua në Tokë (2:37); së dyti, xheneti i botës së përtejme është një vend nga i cili, sipas Kuranit, askush nuk dëbohet kurrë, pasi të ketë hyrë një herë në të (15:49), ndërsa *xhenetin* ku që Ademi, u detyrua ta linte (2:37). Kjo tregon se xheneti ose kopshti në të cilin banoi Ademi<sup>as</sup>, ishte një vend në këtë tokë, të cilit iu dha ky emër për shkak të pjellorisë së tokës dhe gjithashtu, për shkak të padjallëzisë së njerëzve që banonin aty. Në momentin kur djalli ndërhyri në punët e tyre, Zoti e porositi *Hazret Ademin*<sup>as</sup> dhe popullin e tij të mërgonin dhe të jetonin diku tjetër.

26. Sipas Biblës, *pema e ndaluar* ishte pema e njohjes të së mirës dhe të së keqes (Zanafilla 2:17). Por sipas Kuranit të Shenjtë, pasi hëngrën nga pema e ndaluar, Ademi dhe Hava (Eva) mbetën lakuriq, që do të thotë se, ndryshe nga dija që është burim i mirësisë, pema ishte një burim i së keqes, për sa kohë që ata e gjeten veten të dobët pasi hëngrën diçka nga ajo. Pikëpamja Kuranore është dukshëm e saktë, sepse të privohej njeriu nga dituria do të thoshte të rrëzohej vetë qëllimi për të cilin ai ishte krijuar. Kurani dhe Bibla, megjithatë, duket se

jeni ndër të padrejtët”.<sup>27</sup>

37. Shejtani i nxiti<sup>28</sup> ata të dy rreth asaj (peme) dhe i largoi nga vendi ku ishin më parë, dhe Ne u thamë: “Dilni nga këtu! Ju do të jeni armiq të njëritjetrit e në tokë do të keni qëndrim dhe mjete për një kohë të caktuar”.

38. Më pas Ademi mësoi disa fjalë prej Zotit të tij, prandaj, Ai ia pranoi pendimin. Vërtet, vetëm Ai është Pendimpranuesi, Mëshirëbërësi.

39. Ne u thamë: “Dilni të gjithë nga këtu! Kur t’ju vijë ndonjë udhëzim prej Meje, ata që do ta ndjekin udhëzimin Tim, nuk do të kenë as frikë e as nuk do të pikëllohen”.

40. Kurse ata që do t’i mohojnë dhe do t’i quajnë gënjeshtër shenjat

هَذِهِ الشَّجَرَةُ فَتَكُونُوا مِنَ الظَّالِمِينَ ﴿٢٧﴾

فَأَزَلَّهُمَا الشَّيْطَانُ عَنْهَا فَأَخْرَجَهُمَا مِمَّا كَانَا فِيهِ وَقُلْنَا اهْبِطُوا بَعْضُكُمْ لِبَعْضٍ عَدُوٌّ وَلَكُمْ فِي الْأَرْضِ مُسْتَقَرٌّ وَمَتَاعٌ إِلَىٰ حِينٍ ﴿٢٨﴾

فَتَلَقَّىٰ آدَمَ مِنْ رَبِّهِ كَلِمَاتٍ فَتَابَ عَلَيْهِ ۗ إِنَّهُ هُوَ التَّوَّابُ الرَّحِيمُ ﴿٢٩﴾

قُلْنَا اهْبِطُوا مِنْهَا جَمِيعًا فَإِمَّا يَأْتِيَنَّكُمْ مِنِّي هُدًى فَمَنْ تَبِعَ هُدَايَ فَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ ﴿٣٠﴾

وَالَّذِينَ كَفَرُوا وَكَذَّبُوا بِآيَاتِنَا أُولَٰئِكَ

pajtohen në pikën që pema nuk ishte ndonjë pemë fizike, por është përmendur si një metaforë, sepse pemët fizike nuk kanë karakteristika të tilla që u përmendën qoftë nga Kurani, qoftë nga Bibla. Pra, pema duhet të përfaqësojë diçka tjetër. Fjala arabe *esh-shexheretu* (pema) në arabisht, ka edhe kuptime të tjera. Një kuptim i saj është *grindje* (4:66). Diku tjetër po në Kuran përmenden shembuj të dy llojeve të pemëve: (1) pema e mirë dhe (2) pema e keqe (14:25-27). Gjërat dhe mësimet e pastra krahasohen me pemën e mirë, dhe ato të papastra me pemën e keqe, sepse njeriu korr atë që mbjell. Duke pasur parasysh këto shpjegime, ajeti nënkupton: (1) se Ademi ishte urdhëruar të shmangte grindjet; (2) se ai ishte paralajmëruar për rreziqet se ç’do t’i ndodhte nëse do t’i afrohej pemës së ndaluar, gjërave të ndaluara të Sheriatit që Allahu i kishte shpallur atij.

27. Në arabisht, foljet dhe emrat, përveç njëjësit dhe shumësit, kanë edhe numrin dyjës. Në këtë ajet foljet janë në numrin dyjës, pra Zoti u drejtohet vetëm Ademit dhe gruas së tij. Por kjo nuk do të thotë se vetëm ata dy jetonin në *xhenet*, sepse ajetet vijuese tregojnë se aty kanë qenë edhe të tjerë. Për shembull, më tutje thotë “Dilni të gjithë nga këtu” (2:39), folja është në shumës, gjë që tregon se ata kishin edhe bij të tyre. Lexoni edhe 7:12.

28. Fjala *shejtan* rrjedh nga *shejeta*, dhe shejtan do të thotë ai që shkatërrohet (El-Mu’xhemul-Vasit, zëri: *shīn-elif-tā*). Nuk është e saktë që djalli (*shejtani*) vetë të kishte shkuar te Hava, por ashtu siç edhe sot ai cyt fshehurazi, edhe atëherë fshehurazi i kishte cytur asaj. Djalli “frymëzon” ndonjë njeri me mendimin e keq të tij, dhe ky njeri bëhet përfaqësues i tij. Në të njëjtën mënyrë, djalli duhet t’i ketë cytur mendimin e tij ndonjërit nga armiqtë e fesë edhe në atë kohë. Lexoni edhe 2:35.

Tona, do të jenë banorë të zjarrit, në të cilin do të mbesin gjatë.

﴿أَصْحَابِ النَّارِ هُمْ فِيهَا خَالِدُونَ﴾

41. O bijtë e Izraelit! Kujtojeni bekimin Tim që ju kam dhënë! Përmbusheni premtimin që ma bëtë! Edhe Unë do ta përmbush premtimin që ju bëra dhe vetëm prej Meje kini frikë.

يَبْنِي إِسْرَائِيلَ اذْكُرُوا نِعْمَتِيَ الَّتِي  
أَنْعَمْتُ عَلَيْكُمْ وَأَوْفُوا بِعَهْدِي أُوفِ  
بِعَهْدِكُمْ وَإِيَّايَ فَارْهَبُونِ ﴿٤١﴾

42. Besoni atë që jua kam zbritur si vërtetues të asaj që keni; mos u bëni mohues të parë të tij; mos i këmbeni shenjat e Mia me një vlerë të vogël dhe, vetëm prej Meje druheni.

وَأْمُوا بِمَا أَنْزَلْتُ مُصَدِّقًا لِمَا مَعَكُمْ وَلَا  
تَكُونُوا أَوَّلَ كَافِرٍ بِهِ ۗ وَلَا تَشْتَرُوا بِآيَتِي  
ثَمًا قَلِيلًا ۗ وَإِيَّايَ فَاتَّقُونِ ﴿٤٢﴾

43. Mos e përzieni të vërtetën me të rremen dhe, të vërtetën mos e fshihni me vetëdije.

وَلَا تَلْبَسُوا الْحَقَّ بِالْبَاطِلِ وَتَكْتُمُوا الْحَقَّ  
وَأَنْتُمْ تَعْلَمُونَ ﴿٤٣﴾

44. Falni namazin, jepni zekatin dhe përlumi së bashku me të përlulurit.

وَأَقِمُوا الصَّلَاةَ وَآتُوا الزَّكَاةَ وَارْكَعُوا مَعَ  
الرُّكْعَيْنِ ﴿٤٤﴾

45. A urdhëroni njerëzit për mirësi dhe veten e harroni, edhe pse e lexoni Librin?! A nuk kuptoni?

أَتَأْمُرُونَ النَّاسَ بِالْبِرِّ وَتَنْسَوْنَ أَنْفُسَكُمْ  
وَأَنْتُمْ تَتْلُونَ الْكِتَابَ أَفَلَا تَعْقِلُونَ ﴿٤٥﴾

46. Kërkoni ndihmë përmes durimit e namazit! Kjo me të vërtetë është e rëndë, përveçse për të përlulurit;

وَأَسْتَعِينُوا بِالصَّبْرِ وَالصَّلَاةِ ۗ وَإِنَّهَا لَكَبِيرَةٌ  
إِلَّا عَلَى الْخَاشِعِينَ ﴿٤٦﴾

47. të cilët janë të bindur se do ta takojnë Zotin e tyre dhe se tek Ai do të kthehen.

الَّذِينَ يَطُّونَ أَنَّهُمْ مُلْقُوا رَبَّهُمْ وَأَنَّهُمْ  
﴿٤٧﴾ إِلَيْهِ رُجْعُونَ ﴿٤٧﴾

48. O bijtë e Izraelit! Kujtojeni bekimin Tim që ju kam dhënë dhe që ju kam ngritur mbi botët.

يَبْنِي إِسْرَائِيلَ اذْكُرُوا نِعْمَتِيَ الَّتِي أَنْعَمْتُ  
عَلَيْكُمْ وَأَنَا فَصَلَّتْكُمْ عَلَى الْعَالَمِينَ ﴿٤٨﴾

49. Frikësojuni asaj dite kur askush nuk mund të shpërblejë askënd, nuk do të pranohet ndërmjetësim prej askujt, nuk do të merret shpërblësë prej asnjërit dhe as nuk do të ndihmohen.

50. Dhe (kujtojeni) kur ju shpëtuaam prej popullit të Faraonit, të cilët ju shtypnin tejet rëndë, jua thernin djemtë, ndërsa gratë jua mbanin të gjalla. Me këtë kishit sprovë shumë të madhe prej Zotit tuaj.

51. Dhe kur çamë detin për ju dhe ju shpëtuaam, kurse popullin e Faraonit e fundosëm dhe ju e patë.

52. Dhe kur i premtuaam Musait dyzet net,<sup>29</sup> pas (largimit të) tij, ju sërish e bëtë vëçin zot dhe ishit të padrejtë.

53. Prapëseprapë, Ne ju falëm, që të bëheshit mirënjohës.

54. Dhe (kujtojeni) kur i dhamë Musait Librin dhe dalluesin, që të udhëzoheshit.

55. Dhe kur Musai i tha popullit të tij: “O populli im! Vërtet ju shkelët veten tuaj, duke e marrë vëçin për zot. Kthehuni, pra, të penduar te Krijuesi juaj dhe vritni veten tuaj.”<sup>30</sup> Kjo te

وَ اتَّقُوا يَوْمًا لَا تَجْرِي نَفْسٌ عَنْ نَفْسٍ شَيْئًا وَلَا يُقْبَلُ مِنْهَا شَفَاعَةٌ وَلَا يُؤْحَدُ مِنْهَا عَدْلٌ وَلَا هُمْ يُصْرُونَ ﴿٤٩﴾

وَ إِذْ نَجَّيْنَاهُمْ مِنْ آلِ فِرْعَوْنَ يَسُومُونَكُمْ سُوءَ الْعَذَابِ يُدَبِّحُونَ أَبْنَاءَكُمْ وَيَسْتَحْيُونَ نِسَاءَكُمْ وَ فِي ذُرِّيَّتِكُمْ بَلَاءٌ مِّنْ رَبِّكُمْ عَظِيمٌ ﴿٥٠﴾

وَ إِذْ فَرَقْنَا بَيْنَكُمْ الْبَحْرَ فَأَنْجَيْنَاكُمْ وَ أَعْرَفْنَا آلَ فِرْعَوْنَ وَ أَنْتُمْ تَنْظُرُونَ ﴿٥١﴾

وَ إِذْ وَعَدْنَا مُوسَىٰ أَرْبَعِينَ لَيْلَةً ثُمَّ اتَّخَذْتُمُ الْعِجْلَ مِنْ بَعْدِهِ وَ أَنْتُمْ ظَالِمُونَ ﴿٥٢﴾

ثُمَّ عَفَوْنَا عَنْكُمْ مِّنْ بَعْدِ ذَلِكَ لَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ ﴿٥٣﴾

وَ إِذْ آتَيْنَا مُوسَىٰ الْكِتَابَ وَ الْفُرْقَانَ لَعَلَّكُمْ تَهْتَدُونَ ﴿٥٤﴾

وَ إِذْ قَالَ مُوسَىٰ لِقَوْمِهِ يُقَوْمِ إِنَّا كُنَّا ظَالِمِينَ أَنفُسَكُمْ بِإِتِّخَادِكُمُ الْعِجْلَ فَتُوبُوا إِلَىٰ بَارِئِكُمْ فَاقْتُلُوا أَنفُسَكُمْ ط ذُرِّيَّتِكُمْ

29. Lexoni 7:143.

30. Nuk do të thotë që ata të vrisnin veten. *Enfuse-kum* do të thotë *vetja juaj*; të afërmit tuaj; dëshirat tuaja të ulëta. *Enfus* është shumësi i fjalës *nefs*, që gjithashtu do të thotë *dëshirë*. Për të pasur pastrimin shpirtëror, bijtë e Izraelit ishin urdhëruar të luftonin dëshirat e tyre,

Krijuesi juaj është më e mira për ju”. Pastaj Ai jua pranoi pendesën duke ju mëshiruar. Pa dyshim, Ai është Pendimpranuesi, Mëshirëbërësi.

56. Dhe kur ju<sup>31</sup> thatë: “O Musa! Ne kurrë nuk do të të besojmë ty, derisa nuk do ta shohim Allahun haptazi”, ju zuri vetëtima dhe shikonit të shastisur.

57. Sërish ju ngritëm pas (gjendjes suaj të) vdekjes, që të bëheshit mirënjohës.<sup>32</sup>

58. Ju nënshtruam retë që t’ju bënë hije dhe ju zbritëm *manën* dhe *selvanë* (dhe ju thamë) “Hani nga ushqimet e pastra që ju dhamë”. Ata nuk na bënë padrejtësi Neve, por i bënë padrejtësi vetvetes.<sup>33</sup>

خَيْرٌ لَّكُمْ عِنْدَ بَارِيكُمْ ۖ فَتَابَ عَلَيْكُمْ ۗ  
إِنَّهُ هُوَ التَّوَّابُ الرَّحِيمُ ۝

وَإِذْ قُلْتُمْ يَا مُوسَىٰ لَنْ نُؤْمِنَ لَكَ حَتَّىٰ  
نَرَى اللَّهَ جَهْرَةً فَأَخَذَتْكُمُ الصَّعِقَةُ  
وَأَنْتُمْ تَنْظُرُونَ ۝

ثُمَّ بَعَثْنَا مِنْ بَعْدِ مَوْتِكُمْ لَعَلَّكُمْ  
تَشْكُرُونَ ۝

وَظَلَّلْنَا عَلَيْكُمُ الْغَمَامَ وَأَنْزَلْنَا عَلَيْكُمُ الْمَنَّٰ  
وَالسَّلْوَىٰ ۗ كُلُوا مِنْ طَيِّبَاتِ مَا رَزَقْنَاكُمْ ۗ  
وَمَا ظَلَمُونَا وَلَكِنْ كَانُوا أَنْفُسَهُمْ  
يُظْلِمُونَ ۝

metodë e cila në kuptimin e figurshëm quhet “vetasgjësim”. Kurse pohimi që gjendet në Bibël se ata u urdhëruan që “*secili të vrasë vëllanë e tij, mikun e tij, fqinjin e tij!*” (Bibla, Eksodi 32:27), nuk mbështetet nga Kurani, pasi Kurani pohon se ata u falën (4:154), madje edhe udhëheqësi i devijuar i tyre, Samiriu, nuk u vra (20:98). Edhe fjalët vijuese të këtij ajeti: “*jua pranoi pendesën duke ju mëshiruar ...*” e mbështesin këtë komentim në lidhje me bijtë e Izraelit.

31. Vihet re se në shumë nga këto ajete, Zoti i Madhërisëm u drejtohet hebrejve të kohës së Profetit Muhammed<sup>savs</sup> dhe u kujton disa veprime të rënda dhe të padrejta, të cilat nuk i kishin bërë ata, por i kishin bërë hebrejntë e kohës së *Hazret* Musait<sup>as</sup> dhe të kohëve të tjera, të cilët kishin mijëra vjet që kishin vdekur. Prapëseprapë të gjithë dijetarët muslimanë as nuk e vënë në dyshim faktin se nuk ishin ringjallur hebrejntë e kohëve të tjera, duke insistuar se meqë Allahu i ka përmendur në veten e dytë hebrejntë e së kaluarës, Ai patjetër duhet t’i ketë ringjallur ata sepse asgjë nuk është përtej fuqisë së Tij, përkundrazi, i interpretojnë dhe nxjerrin përfundimin logjik se nuk bëhet fjalë për ringjalljen e njerëzve të disamijëvjetëve të mëparshëm. Por kur Profeti Muhammed<sup>savs</sup> bëri profecinë se Isai i biri i Merjemes do të vinte në mesin e muslimanëve, edhe pse Kurani i Shenjtë atë e deklaroi të vdekur (5:116-117; 3:56; 3:145; 21:9 etj..), çuditërisht disa muslimanë insistojnë të vijë fizikisht i njëjti që ka qenë para disa mijë vitesh!

32. D.m.th. – Ne jua gjallëruam besimin, ju shtuam pasardhës dhe ju forcuam.

33. Fjala arabe për *manën* është *men-ne*, që do të thotë mirësi. Andaj, gjithçka që ata morën nga mirësia e Allahut është *men-ne*. I Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> tha: “*Tartufi është një men-ne*”

59. Dhe (kujtoni) kur thamë: “Hyni në këtë fshat dhe aty hani lirisht çfarë të doni! Hyni nga porta duke qenë të bindur dhe thoni: “Na u lehtësofshin barrët!”, Ne do t’jua falim gabimet, dhe mirëbërësve do t’u japim edhe më shumë”.

60. Ata që bënë padrejtësi, e ndërruan me diçka tjetër fjalën që u ishte thënë. Andaj, Ne lëshuam mbi të padrejtët një ndëshkim nga qielli, për shkak se ishin të pabindur.

61. Dhe kur Musai kërkoi ujë për popullin e tij, i thamë: “Bjeri shkëmbit me shkopin tënd!” Atëherë nga ai shpërthyen dymbëdhjetë burime. Çdo fis u njoh me burimin e vet. “Hani e pini nga ushqimi i Allahut dhe mos përhapni trazira në tokë si çrregullues”.

62. Dhe kur ju thatë: “O Musa! Ne kurrësi nuk do të durojmë vetëm me një ushqim, prandaj, lutju Zotit tënd që Ai të na dhurojë nga ato që bën toka, si perime, tranguj, drithëra, thjerrëza dhe qepë”. Ai tha: “A doni ta zëvendësoni të mirën me atë që është më e pavlerë? Hyni në ndonjë qytet se do ta gjeni atë që kërkuat”. Ata i zuri poshtërimi e mjerimi dhe ata morën zemërimin e Allahut. Kjo (u ndodhi) për shkak se ata i mohonin shenjat e Allahut dhe i vrisnin Profetët pa të drejtë; kjo (u ndodhi) sepse ata u

وَإِذْ قُلْنَا ادْخُلُوا هَذِهِ الْقَرْيَةَ فَكُلُوا مِنْهَا  
حَيْثُ شِئْتُمْ رَغَدًا وَادْخُلُوا الْبَابَ سُجَّدًا  
وَ قُولُوا حِطَّةٌ نَّعْفِرْ لَكُمْ حَطَايِكُمْ  
وَ سَنَزِيدُ الْمُحْسِنِينَ ﴿٥٩﴾

فَبَدَّلَ الَّذِينَ ظَلَمُوا قَوْلًا غَيْرَ الَّذِي قِيلَ  
لَهُمْ فَأَنْزَلْنَا عَلَى الَّذِينَ ظَلَمُوا رِجْزًا مِّنْ  
عِنْدِ السَّمَاءِ بِمَا كَانُوا يَفْسُقُونَ ﴿٦٠﴾

وَإِذِ اسْتَسْقَى مُوسَى لِقَوْمِهِ فَقُلْنَا اضْرِبْ  
بِعَصَاكَ الْحَجَرَ ط فَانفَجَرَتْ مِنْهُ اثْنَتَا  
عَشْرَةَ عَيْنًا ط قَدْ عَلِمَ كُلُّ أُنَاسٍ مَّشْرَبَهُمْ ط  
كُلُوا وَاشْرَبُوا مِنْ رِزْقِ اللَّهِ وَلَا تَعْثَوْا فِي  
الْأَرْضِ مُفْسِدِينَ ﴿٦١﴾

وَإِذْ قُلْتُمْ يَا مُوسَى لَنْ نَّصْبِرَ عَلَى طَعَامٍ  
وَاحِدٍ فَادْعُ لَنَا رَبَّكَ يُخْرِجْ لَنَا مِمَّا تُثَمِّتُ  
الْأَرْضُ مِنْ بَقْلِهَا وَقِثَّائِهَا وَفُومِهَا  
وَعَدَسِهَا وَبَصَلَهَا ط قَالَ أَسْتَبْدِلُونَ الَّذِي  
هُوَ أَدْنَى بِالَّذِي هُوَ خَيْرٌ ط اهْبِطُوا مِصْرًا  
فَإِنَّ لَكُمْ مَّا سَأَلْتُمْ ط وَضُرِبَتْ عَلَيْهِمُ  
الدِّبَّةُ وَالْمَسْكَنَةُ ط وَبَاءُوا بِغَضَبٍ مِّنْ  
اللَّهِ ط ذَلِكَ بِأَنَّهُمْ كَانُوا يَكْفُرُونَ بِآيَاتِ  
اللَّهِ وَيَقْتُلُونَ النَّبِيِّنَ بِغَيْرِ الْحَقِّ ط ذَلِكَ بِمَا

(Tirmidhi, nr. 2068). Po kështu, rrëshira që lëshojnë disa bimë dhe që është e ëmbël, quhet *men-ne*. Kurse *selva* është thëllëza. Andaj, kuptimi i ajetit është – Ne krijuam për ju me bollëk tartufë, rrëshirë të ëmbël dhe thëllëza.

rebeluan dhe kaluan çdo kufi.

عَصَوْا وَكَانُوا يَعْتَدُونَ ﴿١٦﴾

63. Sigurisht, ata që besuan, ata që janë hebrenj, të krishterët, *sabi'inët*, cilido prej tyre që besoi Allahun dhe Ditën e Fundit dhe bëri të mira, e ka shpërblimin te Zoti i tij. Të tillët nuk do të kenë as frikë e as nuk do të pikëllohen.<sup>34</sup>

إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَالَّذِينَ هَادُوا وَالنَّصَارَى  
وَالصَّيِّئِينَ مَنْ آمَنَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ  
وَعَمِلَ صَالِحًا فَلَهُمْ أَجْرُهُمْ عِنْدَ رَبِّهِمْ  
وَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ ﴿١٦﴾

64. Dhe (kujtoni) kur morëm besëlidhjen tuaj dhe ngritëm Turin mbi ju<sup>35</sup> (dhe thamë) “Kapeni fuqimisht atë që jua kemi dhënë dhe mbajeni mend përmbajtjen e saj, që të mund të shpëtoni (nga shkatërrimi)”.

وَإِذْ أَخَذْنَا مِيثَاقَكُمْ وَرَفَعْنَا فَوْقَكُمُ  
الطُّورَ طُ خُذُوا مَا آتَيْنَكُم بِقُوَّةٍ وَاذْكُرُوا  
مَا فِيهِ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ ﴿١٦﴾

65. Por ju, edhe pas kësaj, ia kthyet shpinën. Po të mos kishit bekimin (e veçantë) të Allahut dhe mëshirën e Tij, patjetër do të ishit humbës.

ثُمَّ تَوَلَّيْتُمْ مِّنْ بَعْدِ ذَلِكَ فَلَوْلَا فَضْلُ اللَّهِ  
عَلَيْكُمْ وَرَحْمَتُهُ لَكُنْتُمْ مِنَ الْخَاسِرِينَ ﴿١٦﴾

66. Ju pa dyshim i njohët ata që gjenden mes jush, që i shkelën

وَلَقَدْ عَلِمْتُمُ الَّذِينَ اعْتَدَوْا مِنْكُمْ فِي

34. Për arabët, *sabi* ishte ai që linte fenë e tij (idhujtarinë) për t'u konvertuar në një fe të re. Megjithatë, *sabi* quheshin edhe ata që ndiqnin një fe të caktuar dhe që gjendeshin në disa zona të Arabisë dhe jashtë saj. Disa njerëz keqkuptojnë këtë ajet duke menduar se vetëm besimi në Zot dhe në Ditën e Gjykimit është i mjaftueshëm për *shpëtimin*. Kurani thekson në shumë ajete të tjera se besimi në të Dërguarin e Allahut është pjesë esenciale e fesë (4:151-152; 6:93) dhe përbën pjesë integrale të besimit në Zot; po kështu, edhe besimi në Ditën e Gjykimit përfshin besimin në Shpalljen Hyjnore të kohës (4:151-153; 6:93). Në fakt, ky ajet synon të hedhë poshtë besimin e gabuar të hebrenjve që thoshin se “vetëm ata janë populli i zgjedhur i Zotit”, dhe si të tillë, janë të vetmit që do ta gëzojnë *shpëtimin*. Ajeti thekson se kushdo nga ithtarët e feve të ndryshme beson në Allah dhe në Ditën e Gjykimit në atë mënyrë siç i ka përshkruar Kurani Allahun dhe Ditën e Gjykimit, do të vlerësohet nga Allahu. Sigurisht, ky ajet dhe ajete të tjera si ky, janë shembuj të pashoq të drejtësisë që bën Kurani i Shenjtë.

35. D.m.th. – Ai ju mblodhi në rrëzën e malit – siç përmendet edhe në Bibël (Eksodi 19:17). Allahu i mblodhi ata rrëzë mali të Turit në atë mënyrë, që mali u dukej i ngritur sipër tyre. Kjo si shprehje përdoret në arabisht. Siç *Hazret Ebu Bekri*<sup>ra</sup>, duke përshkruar udhëtimin e Hixhretit, përdor të njëjtën fjalë me kuptimin e lartpërmendur: “... *neve na u ngrit një shkëmb shumë i madh që na bëri hije...*” (Buhari, nr. 3615). Lexoni edhe 2:94; 4:155.



kufijtë në lidhje me *sabatin*, të cilëve Ne u thamë: “Bëhuni majmunë të poshtër!”<sup>36</sup>

67. Këtë (çnderim të *sabatit*), pra, e shndërruam në vërejtje për shkak të pasojave të tij dhe të kaluarës së tij, dhe e bëmë këshillë për ata që druhen.

68. Dhe kur Musai i tha popullit të tij: “Allahu ju urdhëron të therni një lopë”. Ata i thanë: “A po talleh me ne?!” Ai tha: “Allahu më ruajttë të mos bëhem ndër të paditurit!”.

69. Ata i thanë: “Lute Zotin tënd që të na sqarojë se çfarë është ajo?” Ai u tha: “Ai thotë se ajo është një lopë, as e plakur, as e re, por e mesme në moshë. Pra, bëjeni atë që ju është urdhëruar!”.

70. Ata i thanë: “Lute Zotin tënd që të na sqarojë se çfarë ngjyre ka ajo?” Ai u tha: “Ai thotë se ajo është një lopë e verdhë, me ngjyrë të ndezur, të cilën e pëlqejnë shikuesit”.

71. Ata i thanë: “Lute Zotin tënd që të na sqarojë se cila është ajo, sepse na janë ngatërruar të gjitha lopët dhe

السَّبْتِ فَقُلْنَا لَهُمْ كُونُوا قِرَدَةً خَاسِئِينَ ﴿٦٦﴾

فَجَعَلْنَاهَا نَكَالًا لِّمَا بَيْنَ يَدَيْهَا وَمَا خَلْفَهَا  
وَمَوْعِظَةً لِّلْمُتَّقِينَ ﴿٦٧﴾

وَإِذْ قَالَ مُوسَىٰ لِقَوْمِهِ إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُكُمْ  
أَنْ تَذْبَحُوا بَقْرَةً ۗ قَالُوا أَتَتَّخِذُنَا هُرُوقًا  
قَالَ أَعُوذُ بِاللَّهِ أَنْ أَكُونَ مِنَ الْجَاهِلِينَ ﴿٦٨﴾

قَالُوا ادْعُ لَنَا رَبَّكَ يُبَيِّنْ لَنَا مَا هِيَ ۗ  
قَالَ إِنَّهُ يَقُولُ إِنَّهَا بَقْرَةٌ وَلَا فَارِصٌ  
وَلَا يَكْرَهُ عَوَانُ بَيْنَ ذَلِكَ ۗ فَافْعَلُوا مَا  
تُؤْمَرُونَ ﴿٦٩﴾

قَالُوا ادْعُ لَنَا رَبَّكَ يُبَيِّنْ لَنَا مَا لَوْنُهَا ۗ  
قَالَ إِنَّهُ يَقُولُ إِنَّهَا بَقْرَةٌ صَفْرَاءٌ ۗ فَاقْعِ  
لَوْنَهَا ۗ تَسْرُّ النَّظِيرِينَ ﴿٧٠﴾

قَالُوا ادْعُ لَنَا رَبَّكَ يُبَيِّنْ لَنَا مَا هِيَ ۗ إِنَّ  
الْبَقَرَ تَشْبَهُ عَلَيْنَا ۗ وَإِنَّا إِن شَاءَ اللَّهُ

36. Mësimet e Islamit na tregojnë se njeriu që jeton në këtë botë, derisa nuk arrin të përfundojë rrugëtimin e tij të pastrimit shpirtëror, dhe derisa nuk arrin t'i largojë mendimet dhe ndjenjat e këqija nëpërmjet adhurimeve të pastra dhe të sinqerta, i përngjan ndonjë kafshe a krimbi. Në këtë kuptim, Zoti i Madhërishëm i përshkroi hebrenjtë e pabindur se ata ishin bërë majmunë dhe derra. Pra, nuk bëhet fjalë për ndonjë mishërim të tyre në kafshët e përmendura, por se ata u përngjanin këtyre kafshëve në veti dhe në karakter. Në një profeci, edhe i Dërguari i Allahut<sup>saws</sup> e ka përdorur këtë metaforë për dijetarët e këqij. Ai thotë: “Populli im do të përballlet me një ankth dhe njerëzit do t'u drejtohen dijetarëve, por ata do t'i gjejnë majmunë dhe derra”. (Kenzul-ummal, nr. 38727). Lexoni edhe 5:61.

ne, në dashtë Allahu, patjetër do ta gëzojmë udhëzimin.

لَمُهْتَدُونَ ﴿١١﴾

72. Ai u tha: “Ai thotë se ajo është një lopë, që nuk u mbajt nën zgjedhë që të lëvronte tokën ose të vadiste arat. Ajo është e shëndoshë dhe pa ndonjë njollë”. “Tani na the të vërtetën”, thanë ata. Pra, e therën, edhe pse nuk ishin të gatshëm për ta bërë këtë gjë.<sup>37</sup>

قَالَ إِنَّهُ يَقُولُ إِنَّهَا بَقَرَةٌ لَا ذَلُولَ تُثِيرُ  
الْأَرْضَ وَلَا تَسْقِي الْحَرْثَ مُسَلَّمَةٌ  
لَا شِيَةَ فِيهَا قَالُوا إِنَّ جِئْتَنَا بِالْحَقِّ  
فَدَبْحُوهَا وَمَا كَادُوا يَفْعَلُونَ ﴿١١﴾

73. Dhe (kujtoni) kur vratë një njeri dhe më pas u përçatë në lidhje me të. Allahu patjetër do ta zbulonte atë që fshihnit.

وَإِذْ قَتَلْتُمْ نَفْسًا فَادَرَأْتُمُ فِيهَا وَاللَّهُ  
مُخْرِجٌ مَّا كُنْتُمْ تَكْتُمُونَ ﴿١٢﴾

74. Andaj, ju thamë: “(Për ta zbardhur të vërtetën) shoshitni këtë (ngjarje) me të tjera kësisoj”. Kështu Allahu ringjall të vdekurit (duke dënuar vrasësit e tyre) dhe ju tregon shenjat e Tij që ju të punoni me mend.<sup>38</sup>

فَقُلْنَا أَصْرَبُوهُ بِبَعْضِهَا كَذَلِكَ يُحْيِي اللَّهُ  
الْمَوْتَىٰ وَيُرِيكُمْ آيَاتِهِ لَعَلَّكُمْ تَعْقِلُونَ ﴿١٣﴾

37. Izraelitët kishin jetuar për një kohë të gjatë midis egjiptianëve, të cilët e adhuronin lopën. Kështu, nderimi për këtë kafshë kishte hyrë edhe në zemrat e izraelitëve. Kjo është arsyeja se kur ata bënë një idhull për vete, e bënë pikërisht në formën e një viçi (Kurani 2:52; Bibla, Eksodi 32:4). Sipas Biblës, ata u urdhëruan vazhdimisht ta sakrifikonin lopën, në mënyrë që mendjet e tyre të pastroheshin nga ndjenjat e nderimit për të (Bibla, Numrat 19:1-9; Levitiku 4:1-21; 16: 3, 11). Vërehet se ata kishin një lopë të veçantë, të cilën e mbanin përzemër dhe që nuk donin ta thernin. Kur Zoti i porositi të thernin një lopë, në vend që të thernin ndonjë lopë, u hyri frika se mos ishte fjala pikërisht për lopën e tyre të preferuar. Kështu ata vazhdimisht i kërkuan Musait<sup>as</sup> që Zoti ta specifikonte lopën. Dhe si rezultat i pyetjeve të tyre, Allahu ua përcakttoi pikërisht lopën e tyre të përzgjedhur.

38. Kurani i Shenjtë nuk pohon se një i vdekur i caktuar, fizikisht të ishte ringjallur. Ajeti tregon se një grup hebrenjsh kishin vrarë një njeri, më pas e fshehën vrasjen dhe zunë të akuzonin të tjerët për këtë krim. Për të gjetur vrasësin, Zoti i porositi të thernin një lopë, e më pas secili prej të dyshuarve, të prekte mishin e lopës së therur me të vdekurin. Ka të ngjarë se kjo të ishte një taktikë hipnotizuese, me anë të së cilës, të ndodhte diçka me vrasësin dhe me mishin që ai kishte kapur, dhe kështu të zbulohet e vërteta. Ky është një kuptim i këtij ajeti nëse përemrin “e saj” (në arabisht “ha”) do t’ia referonim lopës së therur, të përmendur dy ajete më sipër. Por ka edhe një kuptim tjetër që del nëse këtë përemër, në vend të lopës, t’ia referojmë ngjarjes. Në këtë rast, foljen *darebe* (*godit, rrah*), duke iu përmbajtur frazeologjisë arabe, do ta përkthejmë

75. Më pas zemrat tuaja u forcuan, sikur ato t'ju ishin bërë gurë, madje edhe më të forta. Në të vërtetë, ka gurë prej të cilëve shpërthejnë lumenj, ka edhe të tillë që çahen dhe kullojnë ujë. Kështu, edhe prej (zemrave të) tyre ka të atilla që bien nga druajtja ndaj Allahut. Allahu nuk është i pavëmendshëm ndaj asaj që bëni.

76. A shpresoni se ata do t'ju besojnë, ndërkohë që një grup prej tyre e dëgjojnë fjalën e Allahut dhe pasi e kanë kuptuar mirë, e shtrembërojnë me vetëdije?!

77. Kur ata takohen me besimtarët, u thonë: “Ne besuam”, dhe kur janë me njerëzit e tyre, thonë: “A do t'ua tregoni atë që Allahu ju ka treguar juve, që ata ta përdorin atë si argument kundër jush pranë Zotit tuaj?! A nuk kuptoni?!”

78. A nuk e dinë ata se Allahu pa dyshim e di edhe atë që fshehin, edhe atë që shfaqin?!

79. Ndër ta ka edhe të paditur të tillë, që përveç dëshirave asgjë nuk dinë rreth Librit. Ata flasin vetëm me hamendje.

ثُمَّ قَسَتْ قُلُوبُكُمْ مِنْ بَعْدِ ذَلِكَ فَهِيَ كَالْحِجَارَةِ أَوْ أَشَدَّ قَسْوَةً وَإِنَّ مِنَ الْحِجَارَةِ لَمَا يَتَفَجَّرُ مِنْهُ الْأَنْهَارُ وَإِنَّ مِنْهَا لَمَا يَشْقُقُ فَيُخْرِجُ مِنْهُ الْمَاءُ وَإِنَّ مِنْهَا لَمَا يَهْبِطُ مِنْ خَشْيَةِ اللَّهِ وَمَا اللَّهُ بِغَافِلٍ عَمَّا تَعْمَلُونَ ﴿٧٥﴾

أَفَتَطْمَعُونَ أَنْ يُؤْمِنُوا لَكُمْ وَقَدْ كَانَ فَرِيقٌ مِنْهُمْ يَسْمَعُونَ كَلِمَ اللَّهِ ثُمَّ يُحَرِّفُونَهُ مِنْ بَعْدِ مَا عَقَلُوهُ وَهُمْ يَعْلَمُونَ ﴿٧٦﴾

وَإِذَا لَقُوا الَّذِينَ آمَنُوا قَالُوا آمَنَّا وَإِذَا خَلَا بِضَعْفِهِمْ إِلَى بَعْضٍ قَالُوا أَتُحَدِّثُونَهُمْ بِمَا فَتَحَ اللَّهُ عَلَيْكُمْ لِيُحَاجُّوكُمْ بِهِ عِنْدَ رَبِّكُمْ أَفَلَا تَعْقِلُونَ ﴿٧٧﴾

أَوْ لَا يَعْلَمُونَ أَنَّ اللَّهَ يَعْلَمُ مَا يُسِرُّونَ وَمَا يُعْلِنُونَ ﴿٧٨﴾

وَمِنْهُمْ أُمِّيُونَ لَا يَعْلَمُونَ الْكِتَابَ إِلَّا أَمَانِي وَإِنَّهُمْ إِلَّا يُظُنُّونَ ﴿٧٩﴾

النَّحْوِ

*shoshit ose përqsas*, dhe kuptimi është që Zoti u tha ta hetonin gjithë ngjarjen duke e shoshitur atë me ngjarje të tjera të kësaj natyre, sepse përgjithësisht çdo vrasës ka mënyrën e vet për të bërë vrasje. Dhe kjo edhe në hetuesinë moderne merret si bazë e fortë. Në këtë mënyrë, shumë njerëz shpëtojnë të vriten e të vdesin parakohe, gjë që gjithashtu nënkupton se ata të kenë fituar një jetë të re. Edhe mbyllja e këtij ajeti: “*që ju të punoni me mend*”, e mbështet këtë komentim. Në përkthimin e këtij ajeti, i jemi bazuar pikërisht këtij kuptimi.

80. U mjerofshin ata që e shkruajnë Librin me dorën e vet e më pas, për të fituar çmim të vogël me anë të tij, thonë: “ky është prej Allahut!” U mjerofshin për atë që shkruajnë duart e tyre! U mjerofshin edhe për atë që fitojnë!

81. Dhe ata thonë: “Ne nuk do të na prekë zjarri, përveçse për pak ditë të numëruara!” Thuaju: “A keni marrë ndonjë premtim nga Allahu?” (E nëse po,) Allahu patjetër që nuk do ta thyejë premtimin e Tij. Apo ia atribuoni Allahut gjërat që nuk i dini?

82. E vërteta është se ai që bëri vepër të keqe, aq shumë saqë të këqijat e tij e mbërthyen atë, do të jetë banor i zjarrit. Të tillët atje do të jetojnë për një kohë të gjatë.<sup>39</sup>

83. Kurse ata që besuan dhe bënë të mira, janë banorë të xhenetit. Në të do të jetojnë përgjithmonë.

84. Dhe (kujtoni) kur u morëm besëlidhjen bijve të Izraelit: “Nuk do të adhuroni askënd përveç Allahut, do të silleni me mirësi me prindërit, të afërmit, jetimët dhe të varfrit, do t’u flisni njerëzve për të mirë, do të falni namazin dhe do të jepni zekatin!”, me përjashtim të disave, ju ia kthyet shpinën (besëlidhjes). E shpërfillët.

فَوَيْلٌ لِلَّذِينَ يَكْتُوبُونَ انْكِتَابَ بِأَيْدِيهِمْ  
ثُمَّ يَقُولُونَ هَذَا مِنْ عِنْدِ اللَّهِ لَيْسَ شَيْءٌ  
بِهِ نَمًّا قَلِيلًا فَوَيْلٌ لَهُمْ مِمَّا كَتَبَتْ  
أَيْدِيهِمْ وَوَيْلٌ لَهُمْ مِمَّا يَكْسِبُونَ ﴿٣٩﴾

وَقَالُوا لَنْ تَمَسَّنَا النَّارُ إِلَّا أَيَّامًا  
مَعْدُودَةً قُلْ أَتَّخَذْتُمْ عِنْدَ اللَّهِ عَهْدًا  
فَلَنْ يُخْلَفَ اللَّهُ عَهْدَهُ أَمْ تَقُولُونَ عَلَى  
اللَّهِ مَا لَا تَعْلَمُونَ ﴿٤٠﴾

بَلَى مَنْ كَسَبَ سَيِّئَةً وَ أَحَاطَتْ بِهِ  
خَطِيئَتُهُ فَأُولَئِكَ أَصْحَابُ النَّارِ هُمْ فِيهَا  
خَالِدُونَ ﴿٤١﴾

وَالَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ أُولَئِكَ  
أَصْحَابُ الْجَنَّةِ هُمْ فِيهَا خَالِدُونَ ﴿٤٢﴾

وَإِذْ أَخَذْنَا مِيثَاقَ بَنِي إِسْرَائِيلَ لَا  
تَعْبُدُونَ إِلَّا اللَّهَ تَبَّ وَالْوَالِدِينَ إِحْسَانًا  
وَذِي الْقُرْبَىٰ وَالْيَتَامَىٰ وَالْمَسْكِينِ وَقُولُوا  
لِلنَّاسِ حُسْنًا وَأَقِيمُوا الصَّلَاةَ وَآتُوا  
الزَّكَاةَ ثُمَّ تَوَلَّيْتُمْ إِلَّا قَلِيلًا مِّنْكُمْ  
وَأَنْتُمْ مُّعْرِضُونَ ﴿٤٣﴾

39. Allahu quhet Mbuluesi i gabimeve (*Es-Settar*). Ai nuk ua zbulon të tjerëve gabimet e njeriut, derisa ky i fundit nuk e kalon masën, aq sa mëkatet e tij ta kenë rrethuar atë. Pas kësaj fillon faza e ndëshkimit. Prandaj, duhet të gjesh zgjidhje nëpërmjet pendesës, përpara se mëkatet e tua ta kenë përhapur helmin e tyre.

85. Dhe kur ju morëm besëlidhjen: “Nuk do të derdhni gjakun e njëri-tjetrit dhe nuk do të dëboni njëri-tjetrin nga vatrata tuaja”, e pranuat dhe për këtë vetë jeni dëshmitarë.

86. Pastaj, jeni ju që vrisni njerëzit tuaj, dëboni disa prej jush nga shtëpitë e tyre, bashkëpunoni kundër tyre ligësisht e mizorisht. Dhe kur ata ju vijnë të robëruar, i lironi duke marrë shpagim, por ndërkohë dëbimi i tyre ishte i ndaluar për ju! Mos vallë, e besoni Librin pjesërisht dhe pjesërisht e mohoni?! Çfarë duhet të jetë dënimi i njerëzve tuaj që veprojnë në këtë mënyrë, përveçse poshtërimi në jetën e kësaj bote?! Kurse në Ditën e Kiametit, ata do të kthehen në ndëshkimin më të rëndë. Allahu nuk është i pavëmendshëm ndaj asaj që bëni.

87. Pikërisht këta e këmbyen *ahiretin* me jetën e kësaj bote. Prandaj, nuk do t’u pakësohet ndëshkimi e as nuk do të ndihmohen.

88. Pa dyshim, i dhamë Musait Librin dhe pas tij dërguam vazhdimisht të dërguar. I dhamë Isait, të birit të Merjemes, shenjat e qarta dhe e ndihmuam me Shpirtin e shenjtë. Vallë, sa herë që ju vjen ndonjë i dërguar me ndonjë (mësim) që nuk e pëlqeni, a do të bëheni arrogantë, do t’i mohoni dhe disa do t’i vrisni?!

وَإِذْ أَخَذْنَا مِيثَاقَكُمْ لَا تَسْفِكُونَ دِمَاءَكُمْ  
وَلَا تُخْرِجُونَ أَنْفُسَكُمْ مِنْ دِيَارِكُمْ ثُمَّ  
أَقْرَرْتُمْ وَأَنْتُمْ تَشْهَدُونَ ﴿٨٥﴾

ثُمَّ أَنْتُمْ هَؤُلَاءِ تَقْتُلُونَ أَنْفُسَكُمْ  
وَتُخْرِجُونَ فِرْيَقًا مِنْكُمْ مِنْ دِيَارِهِمْ  
تُظْهِرُونَ عَلَيْهِم بِالْإِثْمِ وَالْعُدْوَانِ ط  
وَإِنْ يَأْتُوكُمْ أَسْرَى تُفْدُوهُمْ وَهُمْ  
مُحَرَّمٌ عَلَيْكُمْ إخراجهم ط أَقْتُوهُمْ  
بِغَضِ الْكِتَابِ وَتَكْفُرُونَ بِبَعْضِ ق  
جَزَاءٍ مَنْ يَفْعَلْ ذَلِكَ مِنْكُمْ إِلَّا خِرْيٌ  
فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا ع وَيَوْمَ الْقِيَامَةِ يُرَدُّونَ إِلَى  
أَشَدِّ الْعَذَابِ ط وَمَا اللَّهُ بِعَافٍ عَمَّا  
تَعْمَلُونَ ﴿٨٦﴾

أُولَئِكَ الَّذِينَ اشْتَرَوُا الْحَيَاةَ الدُّنْيَا  
بِالْآخِرَةِ ق فَلَا يُخَفَّفُ عَنْهُمْ الْعَذَابَ وَلَا  
هُمْ يَنْصُرُونَ ع ﴿٨٧﴾

وَلَقَدْ آتَيْنَا مُوسَى الْكِتَابَ وَقَفَّيْنَا مِنْ  
بَعْدِهِ بِالرُّسُلِ ع وَآتَيْنَا عِيسَى ابْنَ مَرْيَمَ  
الْبَيْتَ وَيَدْنُوهُ بِرُوحِ الْقُدُسِ ط أَفَكُلَّمَا  
جَاءَكُمْ رَسُولٌ بِمَا لَا تَهْوَى أَنْفُسُكُمْ  
اسْتَكْبَرْتُمْ ق فَفَرِّقْنَا كَذِبَتُمْ ع وَفَرِّقْنَا  
تَقْتُلُونَ ﴿٨٨﴾

89. Ata thanë: “Zemrat tona kanë perde!” E vërteta është që Allahu i mallkoi ata për shkak të mohimit të tyre. Ndaj, shumë pak besojnë.

90. Dhe kur u erdhi prej Allahut një Libër, vërtetues i atij (mësimi) që ata e kishin, ndonëse deri më parë ata luteshin për ndihmë kundër mohuesve, pra, kur u erdhi ai që ata e njihnin, e mohuan. Mallkimi i Allahut qoftë mbi mohuesit!

91. Sa e keqe është ajo për të cilën ata e shitën veten e tyre: duke u rebeluar kundër faktit që Allahu zbret bekimin e Tij mbi kë të dojë prej robërve të Tij, e mohojnë atë (të vërtetë) që zbriti Allahu. Prandaj, ata tërhoqën zemërim mbi zemërimin, dhe për mohuesit ka ndëshkim poshtërues.

92. Dhe kur u thuhet: “Besojeni atë që zbriti Allahu!”, thonë: “Besojmë atë që na është zbritur neve”, por ata e mohojnë atë (që është zbritur) pas saj, edhe pse ajo është e vërtetë dhe vërtetuese e asaj që ata kanë. Thuaju: “Po të jeni vërtet besimtarë, përse i vrisnit Profetët e Allahut deri më parë?!”

93. Pa dyshim, Musai ju kishte sjellë shenja të qarta, por në mungesë të tij ju e morët viçin për zot. Ishit keqbërës.

94. Dhe kur ju morëm besën tuaj dhe

وَقَالُوا قُلُوبُنَا غُلْفٌ ۗ بَلْ لَعَنَهُمُ اللَّهُ  
بِكُفْرِهِمْ فَكَذَّبُوا مَا يُؤْمِنُونَ ﴿٨٩﴾

وَلَمَّا جَاءَهُمْ كِتَابٌ مِنْ عِنْدِ اللَّهِ مُصَدِّقٌ  
لِمَا مَعَهُمْ ۗ وَكَانُوا مِنْ قَبْلُ يَسْتَفْتِحُونَ  
عَلَى الَّذِينَ كَفَرُوا ۗ فَلَمَّا جَاءَهُمْ مَا  
عَرَفُوا كَفَرُوا بِهِ ۗ فَلَعْنَةُ اللَّهِ عَلَى  
الْكٰفِرِينَ ﴿٩٠﴾

بِسْمَا اشْتَرَوْا بِهِ أَنْفُسَهُمْ أَنْ يَكْفُرُوا  
بِمَا أَنْزَلَ اللَّهُ بَعِيًّا أَنْ يَنْزِلَ اللَّهُ مِنْ  
فَضْلِهِ عَلَى مَنْ يَشَاءُ مِنْ عِبَادِهِ ۗ فَبَاءُوا  
بِعِصْيٍ عَلَى غَضَبٍ ۗ وَلِلْكَافِرِينَ عَذَابٌ  
مُهِينٌ ﴿٩١﴾

وَإِذَا قِيلَ لَهُمُ امْكُفِرُوا بِمَا أَنْزَلَ اللَّهُ قَالُوا  
نُؤْمِنُ بِمَا أَنْزَلَ عَلَيْنَا وَيَكْفُرُونَ بِمَا  
وَرَأَوْهُ ۗ وَهُوَ الْحَقُّ مُصَدِّقًا لِمَا مَعَهُمْ ۗ  
قُلْ فَلِمَ تَقْتُلُونَ أَنْبِيَاءَ اللَّهِ مِنْ قَبْلُ إِنْ  
كُنْتُمْ مُؤْمِنِينَ ﴿٩٢﴾

وَلَقَدْ جَاءَكُمْ مُوسَىٰ بِالْبَيِّنَاتِ ثُمَّ اتَّخَذْتُمُ  
الْعِجْلَ مِنْ بَعْدِهِ وَأَنْتُمْ ظَالِمُونَ ﴿٩٣﴾

وَإِذْ أَخَذْنَا مِيثَاقَكُمْ وَرَفَعْنَا فَوْقَكُمُ

mbi ju ngritëm Turin<sup>40</sup> (duke thënë) “Kapeni fuqishëm atë që ju kemi dhënë dhe dëgjoni!” (Prej jush) ata (të cilëve Ne u ishim drejtuar) thanë: “Dëgjuam dhe kundërshtuam!”. Atyre iu dehën zemrat pas vëçit, për shkak të mohimit të tyre. Thuaju: Nëse vërtet jeni besimtarë, sa e keqe qenka kjo që ju urdhëron besimi juaj!

95. Thuaj: “Nëse shtëpia e *ahiretit* tek Allahu është vetëm për ju dhe për askënd tjetër, atëherë dëshirojeni vdekjen, nëse thoni të vërtetën”.

96. Ata, për atë se çfarë duart e tyre çuan përpara, kurrsesi nuk do ta dëshirojnë vdekjen. Allahu i njeh mirë keqbërësit.

97. Dhe pikërisht ata do t’i gjesh më shumë lakmues të jetës, sesa njerëzit e tjerë, madje, edhe më shumë se idhujtarët. Secili prej tyre dëshiron të jetojë një mijë vjet. Por, edhe kjo jetëgjatësi nuk mund t’i shpëtojë dot nga ndëshkimi. Allahu i sheh mirë punët e tyre.

98. Thuaj: Kushdo që ka armik Xhibrailin, (le ta dijë se) pikërisht ai, me urdhrin e Allahut, e zbriti këtë (shpallje) në zemrën tënde, si vërtetuese të asaj që ka përpara dhe si udhëzim dhe lajm i mirë për besimtarët.

99. Kushdo që është armik i Allahut, i engjëjve të Tij, i të Dërguarve të Tij,

الظُّورَ ط حُدُّوْا مَا آتَيْنٰكُمْ بِقُوَّةٍ وَّاسْمَعُوْا ط  
قَالُوْا سَمِعْنَا وَعَصَيْنَا ؕ وَاشْرَبُوْا فِي  
قُلُوْبِهِمُ الْعِجْلَ بَكْفَرِهِمْ ط قُلْ بِسْمَا  
يَأْمُرُكُمْ بِهِ ؕ اِيْمَانُكُمْ اِنْ كُنْتُمْ  
مُّؤْمِنِيْنَ ۝٩٥

قُلْ اِنْ كَانَتْ لَكُمْ الدَّارُ الْاٰخِرَةُ عِنْدَ اللّٰهِ  
خَالِصَةً مِّنْ دُوْنِ النَّاسِ فَتَمَتَّوْا الْمَوْتَ  
اِنْ كُنْتُمْ صٰدِقِيْنَ ۝٩٦

وَلَنْ يَّسْتَوِيَّوْا اَبَدًا بِمَا قَدَّمْتْ اَيْدِيْهِمْ ط  
وَاللّٰهُ عَلِيْمٌ بِالظّٰلِمِيْنَ ۝٩٧

وَلَتَجِدَنَّهُمْ اَحْرَصَ النَّاسِ عَلٰى حَيٰوَةٍ  
وَمِنَ الدّٰيِنِ اَشْرَكُوْا ؕ يُوَدُّ اَحَدُهُمْ لَوْ  
يُعَمَّرَ اَلْفَ سَنَةٍ وَّمَا هُوَ بِمُرْحِرِحِهٖ مِّنْ  
العَذَابِ اَنْ يُعَمَّرَ ط وَاللّٰهُ بَصِيْرٌ بِمَا  
يَعْمَلُوْنَ ۝٩٨

قُلْ مَنْ كَانَ عَدُوًّا لِجِبْرِیْلِ فَاتَّهٖ نَزَّلَهُ  
عَلٰى قَلْبِكَ بِاِذْنِ اللّٰهِ مُصَدِّقًا لِّمَا بَیْنَ  
يَدَيْهِ وَّهَدٰى وَّبَشِّرِ لِلْمُؤْمِنِيْنَ ۝٩٩

مَنْ كَانَ عَدُوًّا لِلّٰهِ وَمَلٰٓئِكَتِهٖ وَرُسُلِهٖ  
وَجِبْرِیْلِ وَمِیْكَلَ فَاِنَّ اللّٰهَ عَدُوٌّ

40. Lexoni 2:64.

i Xhibrailit dhe i Mikailit (le ta dijë se) Allahu është armik i mohuesve.

لِّلْكَافِرِينَ ﴿١٩﴾

100. Ne të kemi zbritur shenja të qarta, të cilat nuk i mohon askush, përveç të ligjve.

وَلَقَدْ أَنْزَلْنَا إِلَيْكَ آيَاتٍ بَيِّنَاتٍ ۚ وَمَا يَكْفُرُ بِهَا إِلَّا الْفٰسِقُونَ ﴿٢٠﴾

101. Sa herë që ata bëjnë një besëlidhje, disa prej tyre, a do ta flakin tej atë?! Në të vërtetë, shumica prej tyre as nuk besojnë.

أَوْ كَلَّمَا عٰهَدُوا عٰهَدًا بٰئِدَهُ فَرِيقٌ مِّنْهُمْ ۗ بَلْ أَكْثَرُهُمْ لَا يُؤْمِنُونَ ﴿٢١﴾

102. Dhe sa herë që u erdhi ndonjë i dërguar prej Allahut, si vërtetues i asaj që ata kishin, një grup prej atyre që u ishte dhënë Libri, e flakën pas shpine Librin e Allahut, gjoja se nuk dinin asgjë.

وَلَمَّا جَاءَهُمْ رَسُوْلٌ مِّنْ عِنْدِ اللّٰهِ مُصَدِّقٌ لِّمَا مَعَهُمْ بَدَّ فَرِيقٌ مِّنَ الَّذِيْنَ اٰتُوْا الْكِتٰبَ ۗ كَتَبَ اللّٰهُ وِرَآءَ ظُهُورِهِمْ كَاْتَهُمْ لَا يَعْلَمُوْنَ ﴿٢٢﴾

103. Dhe ata ndoqën atë që djajtë<sup>41</sup> lexonin kundër mbretërisë së Sulejmanit. Sulejmani nuk ishte mohues,<sup>42</sup> por ishin djajtë ata që mohuan. Ata u mësonin njerëzve magjinë.<sup>43</sup> (Kurse realiteti i asaj) që

وَاتَّبَعُوْا مَا تَتْلُو الشَّيْطٰنُ عَلٰى مُلْكٍ سٰلِمٍ ۚ وَمَا كَفَرَ سٰلِمٌ وَّلٰكِنَّ الشَّيْطٰنُ كَفَرُوْا يُعَلِّمُوْنَ النَّاسَ السِّحْرَ ۗ وَمَا اُنزِلَ عَلٰى الْمَلٰٓئِكِىْنَ بِاٰيٰلِ هٰرُوْتٍ

41. Fjala *shejātīn* (djajtë), nënkupton krerët e hipokritëve dhe të mohuesve, që bëjnë komplete, dhe kjo fjalë po në këtë sure është përdorur edhe për kundërshtarët e Profetit Muhammed<sup>sav</sup>. Lexoni 2:15.

42. Duke komentuar Kuranin e Shenjtë nuk duhet të bazohesh në mite e legjenda, por në fakte, sepse Kurani tregon të vërtetën. Ky ajet ndër të tjera e çliron *Hazret Sulejmanin*<sup>as</sup> nga akuzat se ai të ishte bërë idhujtar për hir të një gruaje. Profeti i Zotit kurrë nuk bëhet mohues, andaj, tha: *Sulejmani nuk ishte mohues*.

43. Fjala *sihr* do të thotë *magjepsje, dinakëri, mashtrim, ligësi, të paraqiturit e gënjeshtres si të vërtetë* (Lane). Kështu, çdo gënjeshtër, mashtrim a dinakëri që synon t'ua fshehtë të vërtetën shikuesve, përfshihet në *sihr*. Duhet ditur se fjala *sihr* në këtë ajet lidhet vetëm me ngjarjen e kohës së Sulejmanit<sup>as</sup>, dhe më pas, kur përmendet ngjarja e Harutit dhe e Marutit, nuk ka asnjë përemër që i referohet kësaj fjale, pra magjisë. Ajo që ajeti tregon është se çfarë hebrejntë ndoqën në tri kohëra të ndryshme gjatë historisë së tyre dhe se si ishin rezultatet e punëve të tyre. Por mjerisht, shumë komentues, duke e bërë magjinë “kryefjalë” të këtij ajeti, kanë mbushur faqe të tëra me përralla në lidhje me *Hazret Sulejmanin*<sup>as</sup>, Harutin e Marutin, përralla të cilat janë sa paradoksale, aq edhe të turpshme.



u zbrit në Babiloni mbi dy engjëjt,<sup>44</sup> Harutin e Marutin,<sup>45</sup> është që ata nuk i mësonin (asgjë) askujt, derisa i sqaronin: “Jemi vetëm një sprovë, andaj ti mos u bëj mohues!” Njerëzit mësonin prej të dyve atë, me të cilën ata bënin ndarje midis burrit dhe gruas. Me anë të saj, ata nuk dëmtonin askënd, përveçse me urdhrin e Allahut. (Kurse ata që mësojnë prej djajve) mësojnë vetëm atë që i dëmton dhe nuk u bën dobi, ndonëse ata e dinë mirë se kushdo që bën një “tregti” të tillë, nuk do të marrë asgjë në *ahiret*. Eh, sa e keqe është ajo, për të cilën ata e shitën veten e tyre! Eh, sikur ta dinin!<sup>46</sup>

وَمَا رُوتٌ ط وَمَا يَعْلَمِينَ مِنْ أَحَدٍ حَتَّى  
يَقُولَا إِنَّمَا نَحْنُ فِتْنَةٌ فَلَا تَكْفُرُ ط  
فَيَتَعَلَّمُونَ مِنْهُمَا مَا يُفَرِّقُونَ بِهِ بَيْنَ  
الْمَرْءِ وَزَوْجِهِ ط وَمَا هُمْ بِبَصَّارِينَ بِهِ  
مِنْ أَحَدٍ إِلَّا يَأْذِنُ اللَّهُ ط وَيَتَعَلَّمُونَ مَا  
يُضُرُّهُمْ وَلَا يَنْفَعُهُمْ ط وَلَقَدْ عَلِمُوا لَمَنِ  
اشْتَرَاهُ مَا لَهُ فِي الْآخِرَةِ مِنْ خَلْقٍ ط  
وَلَيْسَ مَا شَرَوْا بِهِ أَنْفُسَهُمْ ط لَوْ كَانُوا  
يَعْلَمُونَ ﴿٣٥﴾

44. “Dy engjëjt” këtu nënkuptojnë dy njerëz të dëlirë ose dy profetë, sepse ajeti tregon se ata u mësonin njerëzve diçka, dhe sipas Kuranit, engjëjt nuk jetojnë mes njerëzve duke pasur marrëdhënie të lirë me ta (17:96; 21:8; 43:60-61), dhe së dyti, në arabisht, fjala *melek* (engjëll) përdoret edhe për njeri të dëlirë, shembull i së cilës gjendet edhe në Kuran në 12:32.

45. Haruti dhe Maruti, në fakt, ishin dy njerëz me karakter engjëjsh, të cilët, për të sjellë revolucionin, u mësonin njerëzve gjërat që duheshin mbajtur sekret, aq sa nuk duhet t’ua tregonin as bashkëshorteve. Kurani i Shenjtë i shfajëson Harutin dhe Marutin, pasi ata bëjnë një gjë të tillë me urdhrin e Allahut, kurse të tjerët e bëjnë për shkak të egos dhe interesave të tyre. Për kuptimin e këtyre dy emrave, lexoni komentin pasardhës.

46. Kur hebrenjtë e Arabisë panë se Islami po fuqizohej çdo ditë e më shumë dhe ata vetë nuk kishin më ndikimin që të mund ta ndalonin përparimin e tij, filluan të lobonin te të huajt kundër tij. Në kohën kur ata ishin të shtypur dhe të persektuar nga sundimtarët e krishterë, ata ishin strehuar në Persi dhe e kishin zhvendosur qendrën e tyre fetare nga Judah (Jerusalemi) në Babiloni (Hutchinson’s History of the Nations, f. 550). Gradualisht, ata arritën të ushtronin ndikim të madh pranë monarkëve persianë. Kur Islami po përhapej me shpejtësi, ata luajtën zarin më të fortë të tyre. Ishin po këta që pas pak vitesh do ta bindnin Kisanë II që ai t’i jepte urdhrë Badanit, Guvernatorit të Jemenit, në atë kohë provincë e Persisë, për ta arrestuar dhe sjellë Profetin Muhammed<sup>savs</sup> të lidhur me zinxhirë përpara mbretit. Duke iu referuar kompleteve të tilla të hebrenjve të Arabisë, ky ajët u tërheq vëmendjen se edhe pasardhësit e tyre kishin kurdisur komplete dy herë. Së pari, kundër Sulejmanit<sup>as</sup>, kur disa intrigues në bashkëpunim me disa nga hebrenjtë e kohës thurën komplot për ta rrëzuar Sulejmanin<sup>as</sup> dhe se ata komunikonin me kode dhe simbole sekrete (Bibla, 1 Mbretërve 11:29-32; 1 Mbretërve 11:14, 23, 26; II Kronikave 10:2-4). Dhe, së dyti, gjatë robërisë së tyre në Babiloni në kohën e mbretit Nebukadnetsar, në bashkëpunim me dy burra të shenjtë, të përmendur në këtë ajët, Harutin dhe Marutin. *Haruti* dhe *Maruti* janë emra cilësues dhe jo të përveçëm. I pari rrjedh

104. Po të besonin e të tregoheshin të druajtur, do të kishin shpërblim të mirë tek Allahu. Ah, sikur ta dinin!

وَلَوْ أَنَّهُمْ آمَنُوا وَاتَّقَوْا لَمَسُوْبَةٌ مِّنْ عِنْدِ  
اللَّهِ خَيْرٌ لَّوْكَانُوا يَعْلَمُونَ ﴿١٠٤﴾

105. O ju që besuat! (Profetit Tonë) mos i thoni “*rāina*”,<sup>47</sup> por thojini “shikona!” dhe dëgjojeni (atë me vëmendje). Për mohuesit ka ndëshkim të dhimbshëm.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَقُولُوا رَاعِنَا  
وَقُولُوا انظُرْنَا وَاسْمَعُوا ۗ وَلِلْكَافِرِينَ  
عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿١٠٥﴾

106. Ata që mohuan, qoftë nga ithtarët e Librit, qoftë nga idhujtarët, kurrësi nuk duan që t’ju zbresë juve ndonjë mirësi prej Zotit tuaj. Kurse Allahu zgjedh kë të dojë për mëshirën e Tij. Allahu zotëron bekimin madhor.

مَا يَوَدُّ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ أَهْلِ الْكِتَابِ  
وَلَا الْمُشْرِكِينَ أَنْ يُنَزَّلَ عَلَيْكُمْ مِنْ  
خَيْرٍ مِّنْ رَبِّكُمْ ۗ وَاللَّهُ يَخْتَصُّ بِرَحْمَتِهِ  
مَنْ يَشَاءُ ۗ وَاللَّهُ ذُو الْفَضْلِ الْعَظِيمِ ﴿١٠٦﴾

nga folja *herete* d.m.th. *shqyej* dhe i dyti nga *merete*, d.m.th. *thyej* (Lane). Kështu, këta emra nënkuptojnë se qëllimi i këtyre dy njerëzve të shenjtë ishte që ta thyenin dhe ta shqyenin lavdinë e mbretërisë që ishte armike e izraelitëve, Babilonia. Këta dy profetë duket se ishin Axhe dhe Zekerija, biri i Idos, të përmendur në Bibël, në Esdra 5. Sipas Kuranit, Haruti dhe Maruti merrnin vetëm meshkuj në anëtarësimin e tyre dhe jo gra, dhe u thoshin se — jemi vetëm një sprovë prej Zotit — dhe se izraelitët duhet t’i besonin ata dhe nuk duhet t’i refuzonin, për sa kohë që ishte çështje mbijetese dhe, si e tillë, çdo plan do të mbahej sekret. Kur Kiri, Mbreti i Medias dhe i Persisë, u ngrit në pushtet, izraelitët bënë një marrëveshje të fshehtë me të, dhe nëpërmjet tyre, Kiri e pushtoi lehtësisht Babilonin. Në këmbim të këtij shërbimi, Kiri jo vetëm që i liroi hebrenjtë nga prangat e skllavërisë, si dhe i lejoi ata të ktheheshin në Jerusalem, por gjithashtu i ndihmoi në rindërtimin e Tempullit të Solomonit (Historians’ History of the World, II. 126). Ajeti lë të kuptohet se përpjekjet e hebrenjve në dy raste të mëparshme kishin patur rezultate të ndryshme. Në rastin e parë, komploti i tyre i drejtuar kundër Sulejmanit<sup>as</sup> kishte përfunduar në humbjen totale të prestigjit të tyre, të cilën do ta pasonte dëbimi i tyre në Babiloni. Në rastin e dytë, ata morën një kurs të ngjashëm nën dy burra të frymëzuar dhe dolën të suksesshëm. Kurani pohon se hebrenjtë e Arabisë ishin në hapat e baballarëve të tyre të kohës së Sulejmanit<sup>as</sup>, të cilët nuk korrën sukses, përkundrazi, atyre u ra krejt madhështia dhe më pas ata u dëbuan dhe u poshtëruan. Pra, ata ndiqnin shembullin e gabuar, andaj vetëm dështimi dhe dëbimi do të ishin në fatin e tyre.

47. *Rāina* është fjalë arabe. Arsyeya pse u ndalua të thoshin *rāina* është që hipokritët *raina* thoshin me *i* të zgjatur, që do të thotë *çobani ynë*. Pra, në dukje ata pretendonin të thoshin *na kushto vëmendjen*, por në të vërtetë, duke shtrembëruar fjalët, thoshin *çobani ynë*. Kurani i Shenjtë u bëri vërejtje dhe u tha të tregoheshin të sinqertë e të thoshin *undhurna*, që do të thotë, *na shiko*.

107. Në vend të çdo shpalljeje që Ne e shfuqizojmë ose e bëjmë të harrohet, patjetër sjellim një tjetër më të mirë sesa ajo ose të ngjashme me të. A nuk e di se Allahu pa dyshim është i Plotfuqishëm për çdo gjë?!<sup>48</sup>

مَا نَنْسَخْ مِنْ آيَةٍ أَوْ نُنسَخَ نَاتٍ بِخَيْرٍ  
مِّنْهَا أَوْ مِثْلَهَا أَلَمْ تَعْلَمْ أَنَّ اللَّهَ عَلَى  
كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿١٠٧﴾

108. A nuk e di se vetëm i Allahut është sundimi i qiejve dhe i tokës?! Përveç Allahut, ju nuk keni asnjë kujdestar e asnjë ndihmës.

أَلَمْ تَعْلَمْ أَنَّ اللَّهَ لَهُ مُلْكُ السَّمَوَاتِ  
وَالْأَرْضِ وَمَا لَكُمْ مِنْ دُونِ اللَّهِ مِنْ  
وَالِيٍّ وَلَا نَصِيرٍ ﴿١٠٨﴾

109. A mos doni t'i bëni pyetje Profetit tuaj ashtu siç u pyet Musai më parë? Kushdo që ndërron besimin me mohimin, pa dyshim që e ka humbur rrugën e drejtë.

أَمْ تَرِيدُونَ أَنْ تَسْأَلُوا رَسُولَكُمْ كَمَا  
سَأَلَ مُوسَى مِنْ قَبْلُ وَمَنْ يَتَّبِعِ الْكُفْرَ  
بِالْإِيمَانِ فَقَدْ ضَلَّ سَوَاءَ السَّبِيلِ ﴿١٠٩﴾

110. Prej ithtarëve të Librit ka shumë nga ata që, pasi ju të keni pranuar besimin, duan t'ju kthejnë sërish në mohim. Kjo për shkak të smirës që buron prej zemrave të tyre, edhe pse atyre u është bërë e qartë e vërteta. Andaj, falini dhe tolerojini, derisa Allahu të shfaqë vendimin

وَدَّ كَثِيرٌ مِّنْ أَهْلِ الْكِتَابِ لَوْ يَرُدُّوكُمْ  
مِّنْ بَعْدِ إِيمَانِكُمْ كُفْرًا حَسَدًا مِّنْ عِنْدِ  
أَنْفُسِهِمْ مِّنْ بَعْدِ مَا تَبَيَّنَ لَهُمُ الْحَقُّ فَاعْمُوا  
وَاصْفَحُوا حَتَّى يَأْتِيَ اللَّهُ بِأَمْرِهِ إِنَّ اللَّهَ

48. Shpesh ky ajet keqinterpretohet dhe bazuar te ky thuhet se disa ajete të Kuranit janë të shfuqizuara, përfundim ky që është tërësisht i gabuar dhe i pajustificuar. Nuk ka asgjë në këtë ajet dhe as në kontekst, që të tregojë se fjala arabe *ajet* (*shenjë, ajet, shpallje* etj..) t'u referohet ajeteve të Kuranit. Konteksti, si në ajetet e mëparshme, ashtu edhe në vijim, flet për ithtarët e Librit dhe për mërinë e tyre ndaj Shpalljes së re, pra, ndaj Kuranit. Kjo tregon se këtu fjala *ajet* u referohet jo ajeteve të Kuranit, por Shpalljeve ose Librave të mëparshëm. Shpalljet e mëparshme përmbanin dy lloje urdhërimesh: (a) ato që duheshin shfuqizuar për shkak të ndryshimit të kushteve apo të rrethanave, dhe (b) ato që përmbanin të vërtetat absolute, por që kishin nevojë të përsëriteshin, në mënyrë që njerëzve t'u kujtohej e vërteta e harruar. Dhe ajeti në fjalë thotë, për këto arsye, Allahu dërgon Shpalljen e re, më të mirë sesa e mëparshmeja, ose të ngjashme me të. Duke mos e kuptuar këtë ajet, mes shumë dijetarëve muslimanë filloi një polemikë e gjatë për ajetet shfuqizuese dhe ato të shfuqizuara. Këta komentues shpallën afërsisht pesëqind ajete si shfuqizuese dhe po aq si të shfuqizuara. *Hazret* Mirza Ghulam Ahmedi, Imam Mehdiu<sup>as</sup> e tregoi shpjegimin e mësipërm të këtij ajeti dhe pohoi se nuk shfuqizohet asnjë pikë nga Kurani.

e Tij. Allahu pa dyshim është i Plotfuqishëm për çdo gjë.

عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿١٠﴾

111. Falni namazin dhe jepni zekatin. Çdo gjë prej të mirave që bëni për të ardhmen tuaj, do ta gjeni tek Allahu. Me të vërtetë, Allahu sheh mirë gjithçka që bëni.

وَأَقِيمُوا الصَّلَاةَ وَآتُوا الزَّكَاةَ وَمَا تُقَدِّمُوا  
لِأَنفُسِكُمْ مِنْ خَيْرٍ تَجِدُوهُ عِنْدَ اللَّهِ ۗ إِنَّ  
اللَّهَ بِمَا تَعْمَلُونَ بَصِيرٌ ﴿١١﴾

112. Ata thanë: “Askush nuk mund të hyjë në xhenet, përveç atij që është hebre apo i krishterë”. Këto janë vetëm dëshirat e tyre. Thuaju: “Sillni argumentin tuaj, nëse jeni të vërtetë!”

وَقَالُوا لَنْ يَدْخُلَ الْجَنَّةَ إِلَّا مَنْ كَانَ  
هُودًا أَوْ نَصْرًا ۗ تِلْكَ أَمَانِيُّهُمْ ۗ قُلْ  
هَاتُوا بُرْهَانَكُمْ إِن كُنْتُمْ صَادِقِينَ ﴿١٢﴾

113. Jo! E vërteta është se kushdo që ia dorëzon veten Allahut dhe është mirëbërës, do ta ketë shpërblimin e tij te Zoti i tij. Njerëzit e tillë nuk do të kenë as frikë e as nuk do të pikëllohen.

بَلَىٰ ۗ مَنْ أَسْلَمَ وَجْهَهُ لِلَّهِ وَهُوَ مُحْسِنٌ  
فَلَهُ أَجْرُهُ عِنْدَ رَبِّهِ ۗ وَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ  
وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ ﴿١٣﴾

114. Hebrenjtë thonë se të krishterët nuk kanë asnjë bazë dhe të krishterët thonë se hebrenjtë nuk kanë asnjë bazë, ndërkohë ata e lexojnë Librin. Po kështu, edhe ata që nuk dinin asgjë, thanë të njëjtën gjë. Prandaj, në Ditën e Kiametit, Allahu do t'i gjykojë ata për çështjet, në të cilat kundërshtonin njëri-tjetrin.

وَقَالَتِ الْيَهُودُ لَيْسَتِ النَّصْرَىٰ عَلَىٰ شَيْءٍ ۗ  
وَقَالَتِ النَّصْرَىٰ لَيْسَتِ الْيَهُودُ عَلَىٰ شَيْءٍ ۗ  
وَهُمْ يَتْلُونَ الْكِتَابَ ۗ كَذَلِكَ قَالَ الَّذِينَ  
لَا يَعْلَمُونَ مِثْلَ قَوْلِهِمْ ۗ قَالَ اللَّهُ يَحْكُمُ  
بَيْنَهُمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ فِيمَا كَانُوا فِيهِ يَخْتَلِفُونَ ﴿١٤﴾

115. Dhe kush mund të jetë më keqbërës sesa ai që ndalon të përmendet emri i Allahut në xhamitë e Tij dhe që tenton t'i shkretojë ato?! Të tillët duhej që të hynin në to vetëm të frikësuar. Ata do të kenë poshtërim në këtë botë, e në *ahiret* do të kenë ndëshkim të madh.

وَمَنْ أَظْلَمُ مِمَّنْ مَنَعَ مَسْجِدَ اللَّهِ أَنْ  
يُذَكَرَ فِيهَا اسْمُهُ وَسَعَىٰ فِي خَرَابِهَا ۗ  
أُولَٰئِكَ مَا كَانَ لَهُمْ أَنْ يَدْخُلُوهَا إِلَّا  
خَافِينَ ۗ لَهُمْ فِي الدُّنْيَا خِزْيٌ ۗ وَ لَهُمْ فِي  
الْآخِرَةِ عَذَابٌ عَظِيمٌ ﴿١٥﴾

116. Të Allahut janë edhe lindja, edhe perëndimi. Ndaj, ngado që të ktheheni, do të gjeni shfaqjen e Allahut. Pa dyshim, Allahu është Zgjerues, i Gjithëdijshëm.

117. Dhe ata thanë: “Allahu ka marrë (për Vete) një djalë”. I Shenjtë është Ai! Madje, Atij i takon gjithçka që gjendet në qiej e në tokë. Atij i nënshtrohen që të gjithë.

118. Ai është Nismëtari i krijimit të qiejve e të tokës dhe, kur Ai vendos për diçka, vetëm thotë: “Bëhu!”, ajo bëhet.

119. Ata që nuk kanë kurrfarë dije, thonë: “Përse Allahu nuk flet me ne ose (përse) nuk na vjen ndonjë shenjë edhe neve?” Kështu thanë edhe ata që ishin para tyre. Zemrat e tyre i përngjajnë njëra-tjetrës. Ne i kemi sqaruar plotësisht shenjat për popullin që beson bindshëm.

120. Pa dyshim, Ne të kemi dërguar me të vërtetën, si sihariqdhënës dhe si alarmues. Dhe ti nuk do të pyetesh rreth njerëzve të xhehenemit.

121. As hebrenjtë nuk do të kënaqen me ty e as të krishterët, derisa nuk do t'i ndjekësh grupet e tyre. Thuaju: “Udhëzimi i Allahut është udhëzim i vërtetë”. Dhe nëse do të ndjekësh dëshirat e tyre, edhe pse të erdhi dija, nuk do të kesh asnjë kujdestar dhe ndihmës prej Allahut.

وَاللَّهُ الْمَشْرِقُ وَالْمَغْرِبُ فَأَيَمَا تَوَلَّوْا  
فَسَمَّ وَجْهَ اللَّهِ إِنَّ اللَّهَ وَاسِعٌ عَلِيمٌ ﴿١١٦﴾

وَقَالُوا اتَّخَذَ اللَّهُ وَلَدًا سُبْحٰنَهُ ۗ بَلْ لَّهُ مَا  
فِي السَّمٰوٰتِ وَالْاَرْضِ ۗ كُلٌّ لَّهُ قٰسٍتُونَ ﴿١١٧﴾

بَدِيْعُ السَّمٰوٰتِ وَالْاَرْضِ ۗ وَاِذَا قَضٰى  
اَمْرًا فَاِلٰمًا يَقُوْلُ لَهُ كُنْ فَيَكُوْنُ ﴿١١٨﴾

وَقَالَ الَّذِيْنَ لَا يَعْلَمُوْنَ لَوْلَا يَكْتُمُنَا اللّٰهُ  
اَوْ تَأْتِيْنَا اٰيَةٌ ۗ كَذٰلِكَ قَالَ الَّذِيْنَ مِنْ  
قَبْلِهِمْ مِّثْلَ قَوْلِهِمْ ۗ تَشٰبَهَتْ قُلُوْبُهُمْ ۗ  
قَدْ بَيَّنَّا الْاٰيٰتِ لِقَوْمٍ يُوقِنُوْنَ ﴿١١٩﴾

اِنَّا اَرْسَلْنَاكَ بِالْحَقِّ بَشِيْرًا وَّاُنذِيْرًا  
وَلَا تَسْئَلْ عَنْ اَصْحٰبِ الْاَلْبٰبِ ۗ ﴿١٢٠﴾

وَلَنْ تَرْضٰى عَنْكَ الْيَهُودُ وَلَا النَّصْرٰى  
حَتّٰى تَتَّبِعَ مِلَّتَهُمْ ۗ قُلْ اِنَّ هٰدِيَ اللّٰهُ هُوَ  
الْهُدٰى ۗ وَلٰكِنْ اَتَّبَعْتَ اَهْوَاءَهُمْ بَعْدَ  
الَّذِيْ جَآءَكَ مِنَ الْعِلْمِ ۗ مَا لَكَ مِنَ اللّٰهِ  
مِنْ وَّلِيٍّ وَّلَا نَصِيْرٍ ﴿١٢١﴾

122. Ata që u kemi dhënë Librin, që e recitojnë ashtu siç duhet recituar ai, me të vërtetë besojnë në të. Kurse ata që e mohojnë atë, gjithsesi janë të humbur.

123. O bijtë e Izraelit! Kujtojeni bekimin Tim që ju kam dhënë dhe që ju kam ngritur mbi botët.

124. Dhe frikësojuni asaj dite kur askush nuk mund të shpërblejë askënd, as nuk do të merret shpërblese prej askujt, as nuk do të ndihmojë askënd ndonjë ndërmjetësim dhe as nuk do të ndihmohen.

125. Dhe kur Ibrahimin e sprovoi Zoti i tij përmes disa porosive, ai ia përmbushi të gjitha. (Zoti) tha: “Unë pa dyshim do të të bëj prijës për njerëzit”. Ai iu lut: “Edhe prej pasardhësve të mi!” (Zoti) tha: “Premtimi Im nuk do të përfshijë të padrejtët”.

126. Dhe (kujtojeni) kur bëmë Shtëpinë (Tonë) si vend tubimi dhe paqeje për njerëzit. Në qëndrimin e Ibrahimit gjejeni vendin e faljes!<sup>49</sup> E porositem Ibrahimin dhe Ismailin: “Pastrojeni mirë Shtëpinë Time për ata që sillen rreth saj, që qëndrojnë aty për adhurim, që përkulen, e që bëjnë sexhde”.

الَّذِينَ آتَيْنَاهُمُ الْكِتَابَ يَتْلُونَهُ حَقًّا  
تِلَاوَتِهِ ۖ وَأُولَٰئِكَ يُؤْمِنُونَ بِهِ ۖ وَمَنْ يَكْفُرْ بِهِ  
فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْخٰسِرُونَ ﴿١٢٢﴾

يٰۤاِبْنَٓ اِسْرٰٓءٰٓءِٓلْ اذْكُرُوْا نِعْمَتِىَ الَّتِىْ اَنْعَمْتُ  
عَلَيْكُمْ وَاَنْتِىْ فَضَّلْتُمْ كُمْ عَلٰى الْعٰلَمِيْنَ ﴿١٢٣﴾

وَاتَّقُوا يَوْمًا لَّا تَجْرِيْ نَفْسٌ عَنْ نَّفْسٍ شَيْئًا  
وَلَا يُقْبَلُ مِنْهَا عَدْلٌ وَلَا تَنْفَعُهَا شَفَاعَةٌ  
وَلَا هُمْ يُنصَرُونَ ﴿١٢٤﴾

وَإِذْ ابْتَلَىٰٓ اِبْرٰٓهٖمَ رَبُّهُ بِكَلِمٰتٍ فَاَتَمَّهُنَّ ۗ  
قَالَ اِنِّىْ جَاعِلُكَ لِلنَّاسِ اِمٰمًا ۗ قَالَ  
وَمِنْ ذُرِّيَّتِىْ ۗ قَالَ لَا يَبٰٓءُ عَهْدِىَ  
الظٰلِمِيْنَ ﴿١٢٥﴾

وَإِذْ جَعَلْنَا الْبَيْتَ مَثَابَةً لِّلنَّاسِ وَاَمَّا ۗ  
وَاتَّخِذُوْا مِنْ مَّقَامِ اِبْرٰٓهٖمَ مُصَلِّٓمً ۗ وَعَهْدِنَا  
اِلٰى اِبْرٰٓهٖمَ وَاِسْمٰعِيْلَ اَنْ طَهِّرَا بَيْتِىَ  
لِلطّٰٓئِفِيْنَ وَالْحٰكِمِيْنَ وَالرُّكَّعِ السُّجُوْدِ ﴿١٢٦﴾

49. Në vendin e Ibrahimit gjejeni vendin e faljes do të thotë pors Ibrahim tregohuni tërësisht të bindur dhe ndiqeni modelin e tij në adhurimin dhe në besimin tuaj.

127. Dhe kur Ibrahimimi tha: “O Zoti im! Bëje këtë qytet të paqes dhe ushqej banorët e tij që besojnë në Allah dhe në Ditën e Fundit, me fruta të çdolloji”. Ai tha: “Për sa i përket atij që mohon, edhe atij do t’i sjell dobi për pak kohë, e më pas do ta detyroj të shkojë drejt dënimit të zjarrit. Eh, sa destinacion i keq është ai!”

128. Dhe kur Ibrahimimi ngrinte themelet e Shtëpisë, edhe Ismaili po ashtu, (ata luteshin) “O Zoti ynë! Pranoje këtë prej nesh! Me të vërtetë, Ti je Gjithëdëgjuesi, i Gjithëdijshmi!”<sup>50</sup>

129. O Zoti ynë! Na bëj të bindurit e Tu dhe, edhe prej pasardhësve tanë, bëj një popull të të bindurve të Tu, na trego mënyrat e adhurimeve dhe të sakrifikimeve tona dhe na prano pendimin duke na mëshiruar. Me të vërtetë, Ti je Pendimpranuesi, Mëshirëbërësi!

130. O Zoti ynë! Dërgoju atyre një të dërguar nga gjiri i tyre, që t’u recitojë *ajetet*<sup>51</sup> e Tua, t’u mësojë

وَإِذْ قَالَ إِبْرَاهِيمُ رَبِّ اجْعَلْ هَذَا بَلَدًا آمِنًا وَارْزُقْ أَهْلَهُ مِنَ الثَّمَرَاتِ مَنْ آمَنَ مِنْهُمْ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ قَالَ وَمَنْ كَفَرَ فَأُمِّتُهُ قَلِيلًا ثُمَّ أَضْطَرُّهُ إِلَىٰ عَذَابِ النَّارِ وَبِئْسَ الْمَصِيرُ ﴿١٢٧﴾

وَإِذْ يَرْفَعُ إِبْرَاهِيمُ الْقَوَاعِدَ مِنَ الْبَيْتِ وَإِسْمَاعِيلُ رَبَّنَا تَقَبَّلْ مِنَّا إِنَّكَ أَنْتَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ ﴿١٢٨﴾

رَبَّنَا وَاجْعَلْنَا مُسْلِمَيْنِ لَكَ وَمِنْ ذُرِّيَّتِنَا أُمَّةً مُّسْلِمَةً لَّكَ ۗ وَإِرْنَا مَنَايِكَ وَتُبَّ عَلَيْنَا إِنَّكَ أَنْتَ التَّوَّابُ الرَّحِيمُ ﴿١٢٩﴾

رَبَّنَا وَابْعَثْ فِيهِمْ رَسُولًا مِنْهُمْ يَتْلُو عَلَيْهِمْ آيَاتِكَ وَيُعَلِّمُهُمُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ

50. A ishte Ibrahimimi<sup>as</sup> themeluesi i Qabesë, apo vetëm rindërtuesi i saj, është një pyetje që ka shkaktuar diskutime. Disa mendojnë se Ibrahimimi<sup>as</sup> ishte ndërtuesi i parë i saj, kurse të tjerët e gjurmojnë origjinën e tij tek Ademi<sup>as</sup>. Kurani (3:97) dhe traditat autentike mbështesin pikëpamjen se edhe para ngritjes së Qabesë nga Hazret Ibrahimimi<sup>as</sup>, ekzistonte një lloj strukture, por që ishte rrënuar dhe kishin mbetur vetëm ca gjurmë të saj. Fjala *el-kavaid* në këtë ajet tregon se themelet e Shtëpisë ishin aty, të cilat i kishin ngritur Ibrahimimi dhe Ismaili<sup>as</sup>. Përveç kësaj, lutja e Hazret Ibrahimimi<sup>as</sup> në kohën kur ai e kishte lënë familjen e tij (Ismailin<sup>as</sup> dhe nënën e tij) në Mekë – “O Zoti ynë! Kam vendosur disa nga fëmijët e mi në një luginë pa bimësi, pranë Shtëpisë Sate të Shenjtë” (14:38) – tregon se Qabeja kishte ekzistuar edhe para se Hazret Ibrahimimi<sup>as</sup> të kishte vendosur gruan dhe djalin e tij në Luginën e Mekës. Këtë pikëpamje e mbështet edhe hadithi (Buhari, nr. 3364). Të dhënat historike gjithashtu mbështesin mendimin se Qabeja ekziston që nga lashtësia. Lexoni edhe 3:97.

51. Vargjet e Kuranit quhen *ajete*. Ajet do të thotë *shenjë*. Në këtë përkthim, kjo fjalë herë është përkthyer si “shenjë” e herë është lënë në formën origjinale, për t’iu referuar vargjeve të Kuranit

Librin, urtësinë dhe t'i pastrojë ata. Sigurisht, Ti je i Plotfuqishmi, i Urti!

131. E kush mund t'i shmanget grupit të Ibrahimit, përveç atij që e zvetënon veten e vet. Ne pa dyshim e kemi zgjedhur (Ibrahimin) në këtë botë dhe ai edhe në *ahiret* do të jetë ndër të dëlirët.

132. (Kujtojeni) kur Zoti i tij i tha: “Nënshtrohu!” Ai (pa ngurrim) tha: “Iu nënshtrova Zotit të botëve”.

133. Ibrahim i këtu ua porositi edhe bijve të tij, po ashtu edhe Jakubi (duke thënë) “O bijtë e mi! Pa dyshim, këtë fe jua ka zgjedhur Allahu. Prandaj, mos vdisni kurrsesi, përveçse kur të jeni të nënshtroar!”<sup>52</sup>

134. A ishit atëherë kur Jakubit i kishte ardhur momenti i vdekjes, kur ai i pyeti bijtë e tij: “Kë do të adhuron pas meje?”? Ata i thanë: “Do të adhurojmë Zotin tënd dhe Zotin e etërve të tu, të Ibrahimit, të Ismailit dhe të Is’hakut, një Zot të Vetëm dhe Atij i nënshtrohemi”.<sup>53</sup>

135. Ky ishte një popull që ka kaluar. Ai do të ketë atë që ka punuar dhe ju do të keni atë që ju keni punuar. Ju

وَيُرْسِلُهُمْ<sup>٥٢</sup> ط إِنَّكَ أَنْتَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ<sup>٥٣</sup>

وَمَنْ يَرْغَبْ عَنْ مِلَّةِ إِبْرَاهِيمَ إِلَّا مَنْ سَفِهَ نَفْسَهُ<sup>٥٤</sup> وَلَقَدْ اصْطَفَيْنَاهُ فِي الدُّنْيَا<sup>٥٥</sup> وَإِنَّهُ فِي الْآخِرَةِ لَمِنَ الصَّالِحِينَ<sup>٥٦</sup>

إِذْ قَالَ لَهُ رَبُّهُ أَسْلِمْ<sup>٥٧</sup> لَ قَالَ أَسْلَمْتُ لِرَبِّ الْعَالَمِينَ<sup>٥٨</sup>

وَوَصَّى بِهَا إِبْرَاهِيمُ بَنِيهِ وَيَعْقُوبُ<sup>٥٩</sup> بَنِيَّ إِنَّ اللَّهَ اصْطَفَى لَكُمُ الدِّينَ فَلَا تَمُوتُنَّ إِلَّا وَأَنْتُمْ مُسْلِمُونَ<sup>٦٠</sup>

أَمْ كُنْتُمْ شُهَدَاءَ إِذْ حَضَرَ يَعْقُوبَ الْمَوْتُ<sup>٦١</sup> إِذْ قَالَ لِبَنِيهِ مَا تَعْبُدُونَ مِنْ بَعْدِي<sup>٦٢</sup> قَالُوا نَعْبُدُ إِلَهَكَ وَاللَّهُ أَبَائِكَ إِبْرَاهِيمَ وَإِسْمَاعِيلَ وَإِسْحَاقَ<sup>٦٣</sup> إِلَهًا وَاحِدًا<sup>٦٤</sup> وَنَحْنُ لَهُ مُسْلِمُونَ<sup>٦٥</sup>

تِلْكَ أُمَّةٌ قَدْ خَلَتْ<sup>٦٦</sup> لَهَا مَا كَسَبَتْ وَلَكُمْ مَا كَسَبْتُمْ<sup>٦٧</sup> وَلَا تُسْأَلُونَ عَمَّا كَانُوا

ose shpalljeve të Zotit. Çdo varg i Kuranit është *shenjë* e Allahut, sepse është shpallje e Tij.

52. Se kur i vjen vdekja njeriut, kjo nuk është në dorën e tij. Andaj, kuptimi i kësaj porosie është – *Gjithmonë jini të nënshtroar, në mos ju zë vdekja në një situatë tjetër!*

53. Ismaili<sup>as</sup> ishte xhaxhai i Jakubit<sup>as</sup> (Jakubi<sup>as</sup> u quajt edhe Izrael), dhe megjithatë fëmijët e Jakubit, pra bijtë e Izraelit, në këtë ajet, e përfshijnë Ismailin<sup>as</sup> në mesin e “etërve” të tyre, gjë që tregon se fjala *eb* e arabishtes (baba) ndonjëherë nënkupton edhe xhaxhain. Bijtë e Jakubit, pra, izraelitët, tregonin respekt të madh ndaj *Hazret Ismailit*<sup>as</sup>, xhaxhait të tyre.



nuk do të pyeteni rreth asaj që ata punonin.

136. Dhe ata thonë: “Bëhuni hebrenj ose të krishterë, do të udhëzoheni!” Thuaju: Jo! Bëhuni prej grupit të Ibrahimit të nënshtruar (ndaj Zotit), që nuk ka qenë idhujtar.

137. Thoni: “Ne besuam në Allah, në atë që na është zbritur neve, në atë që i ishte zbritur Ibrahimit, Ismailit, Is’hakut, Jakubit dhe bijve (të tij)<sup>54</sup> dhe në atë që i ishte dhënë Musait, Isait dhe në atë që u ishte dhënë Profetëve prej Zotit të tyre. Nuk bëjmë ndarje midis asnjërit prej tyre dhe Atij i jemi nënshtruar”.

138. Ata, po besuan, ashtu siç ju keni besuar në Të, patjetër që do të udhëzohen; po ia kthyen shpinën, atëherë (dije se si zakonisht) ata kanë mbetur në kundërshti. Ty do të të mjaftojë Allahu kundër tyre. Ai është Gjithëdhëgjuesi, i Gjithëdhijshmi.

139. “Përvetësoni ngjyrën e Allahut! E kush mund të jetë më i bukur sesa Allahu në ngjyrë?! Ne Atë e adhurojmë.”

140. Thuaju: “A po ziheni me ne për Allahun, edhe pse Ai është Zoti ynë dhe Zoti juaj? Ne kemi veprat tona

يَعْمَلُونَ ﴿١٣٦﴾

وَقَالُوا كُونُوا هُودًا أَوْ نَصَارَى تَهْتَدُوا  
قُلْ بَلْ مِلَّةَ إِبْرَاهِيمَ حَنِيفًا وَمَا كَانَ  
مِنَ الْمُشْرِكِينَ ﴿١٣٧﴾

قُولُوا آمَنَّا بِاللَّهِ وَمَا أُنزِلَ إِلَيْنَا وَمَا أُنزِلَ  
إِلَىٰ إِبْرَاهِيمَ وَإِسْمَاعِيلَ وَإِسْحَاقَ وَيَعْقُوبَ  
وَالْأَسْبَاطِ وَمَا أُوتِيَ مُوسَىٰ وَعِيسَىٰ وَمَا  
أُوتِيَ النَّبِيُّونَ مِن رَّبِّهِمْ ۚ لَا نُفَرِّقُ بَيْنَ  
أَحَدٍ مِّنْهُمْ ۗ وَنَحْنُ لَهُ مُسْلِمُونَ ﴿١٣٨﴾

فَإِنْ آمَنُوا بِمِثْلِ مَا آمَنْتُمْ بِهِ فَقَدِ اهْتَدَوْا  
وَإِنْ تَوَلَّوْا فَإِنَّمَا هُمْ فِي شِقَاقِ  
فَسِيْئَتِكُمْ إِلَى اللَّهِ ۚ وَهُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ ﴿١٣٩﴾

صِبْغَةَ اللَّهِ ۚ وَمَنْ أَحْسَنُ مِنَ اللَّهِ صِبْغَةً  
وَنَحْنُ لَهُ عِبْدُونَ ﴿١٤٠﴾

قُلْ أَتَحَاجُّونَنَا فِي اللَّهِ وَهُوَ رَبُّنَا وَرَبُّكُمْ ۚ  
وَلَنَا أَعْمَالُنَا وَلَكُمْ أَعْمَالُكُمْ ۚ وَنَحْنُ لَهُ

54. Fjala *bij* këtu u referohet dymbëdhjetë fiseve të Izraelit të emërtuar sipas dymbëdhjetë djemve të Jakubit<sup>as</sup>, të cilët sipas Biblës ishin: Rubeni, Simeoni, Levi, Juda, Isakariu, Zabuloni, Jusufi (Jozefi), Beniamini, Dani, Neftali, Gadi dhe Asheri (Zanafilla 35:23-26 dhe 49:28).

dhe ju keni veprat tuaja. Ne Atij i jemi të përkushtuar”.

مُخْلِصُونَ ﴿١٤﴾

141. A thoni se Ibrahim, Ismaili, Is'haku, Jakubi dhe pasardhësit (e tij) ishin hebrenj a të krishterë? Thuaju: “A dini më shumë ju apo Allahu?” E kush mund të jetë më keqberës sesa ai që fsheh dëshminë që ka (si amanet) prej Allahut?! Allahu nuk është i pavëmendshëm ndaj asaj që ju bëni.

أَمْ تَقُولُونَ إِنَّ إِبْرَاهِيمَ وَإِسْمَاعِيلَ وَإِسْحَاقَ وَيَعْقُوبَ وَالْأَسْبَاطَ كَانُوا هُودًا أَوْ نَصَارَى قُلْ إِنَّمَا أَعْلَمُ أَمَ اللّٰهِ وَمَنْ أَظْلَمُ مِمَّنْ كَتَمَ شَهَادَةَ عِنْدَهُ مِنْ اللّٰهِ وَمَا اللّٰهُ بِعَاقِلٍ عَمَّا تَعْمَلُونَ ﴿١٤﴾

142. (Edhe) ky ishte një popull që ka kaluar. Ai do të ketë atë që ka punuar dhe ju do të keni atë që ju keni punuar. Ju nuk do të pyeteni rreth asaj që ata punonin.

تِلْكَ أُمَّةٌ قَدْ خَلَتْ لَهَا مَا كَسَبَتْ وَلَكُمْ مَّا كَسَبْتُمْ وَلَا تُسْأَلُونَ عَمَّا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿١٥﴾

Xhuzi 2

143. Njerëzit mendjelehtë patjetër do të thonë: “Çfarë i ktheu ata nga *kiblja*<sup>55</sup> e tyre, së cilës i drejtoheshin?” Thuaj: “E Allahut është edhe lindja edhe perëndimi. Ai udhëzon kë të dojë në rrugën e drejtë”.<sup>56</sup>

سَيَقُولُ السُّفَهَاءُ مِنَ النَّاسِ مَا وَلَّهُمْ عَن قِبَلِهِمُ الَّذِي كَانُوا عَلَيْهَا قُلْ لِلّٰهِ الْمَشْرِقُ وَالْمَغْرِبُ يَهْدِي مَنْ يَشَاءُ إِلَى صِرَاطٍ مُّسْتَقِيمٍ ﴿١٦﴾

55. *Kible* është fjalë e gjuhës arabe që do të thotë *drejtim*. Në terminologjinë e fesë Islame, ajo nënkupton drejtimin nga Qabeja, drejtim në të cilin besimtari duhet të jetë gjatë faljes së namazit.

56. Në disa ajete të mëparshme një referencë e theksuar iu bë faktit se në zbatim të një plani Hyjnor, *Hazret Ibrahim*<sup>as</sup> kishte vendosur gruan e tij, Haxheren, dhe djalin, Ismailin, në Luginën e zymtë dhe djerrë të Mekës. Kur Ismaili u rrit, Ibrahim<sup>as</sup> e rindërtoi Qabenë me ndihmën e tij dhe gjatë rindërtimit të saj iu lut Zotit që të ngrinte në mesin e arabëve një Profet të madh, i cili të ishte Prijësi i njerëzimit për të gjitha kohërat (2:128-130). Pra, deri në kohën e Ibrahimit<sup>as</sup>, vendi ku ndodhej Qabeja ishte një humbëtitirë. Vetëm në kohën kur u shfaq ky Profeti i madh, plani i Zotit hyri në veprim dhe Qabeja u bë *kible* për mbarë njerëzimin. Por ndërsa ishte në Mekë, Profeti i Shenjtë<sup>savs</sup>, në përputhje me praktikën e tij të vjetër dhe gjithashtu me urdhrin Hyjnor, falej duke e drejtuar fytyrën kah Jerusalemi, i cili ishte *kiblja* e Profetëve izraelitë. Pasi mërgoi në Medine ai vazhdoi të falej me fytyrë nga Jerusalemi, por pas disa muajsh, u zbrit urdhri Hyjnor të kthente fytyrën drejt Qabesë.

144. Kështu pra, ju kemi bërë një popull të baraspeshuar,<sup>54</sup> që ju të jeni dëshmitarë mbi njerëzit dhe i Dërguari të jetë dëshmitar mbi ju. *Kiblen* që ti e kishe më parë, e kishim caktuar vetëm që të dallonim atë që ndjek të Dërguarin, nga ai që kthehet mbrapsht. Kjo (sprovë) ka qenë e rëndë, por jo për ata që i ka udhëzuar Allahu. Allahu nuk është i tillë që t'jua humbë besimin. Allahu është shumë i Dhembshur (dhe) shumë Mëshirëbërës ndaj njerëzve.

145. E kemi parë ngritjen e herëpashershme të fytyrës sate kah qielli. Ne patjetër që do të të kthenim kah *kiblja* që ti e doje. Ktheje fytyrën tënde kah Xhamia e shenjtë! Kudo që të gjendeni, kthejeni fytyrën tuaj kah ajo anë. Ata të cilëve u është dhënë Libri, sigurisht që e dinë se kjo është e vërteta prej Zotit të tyre. Allahu nuk është i pavëmendshëm ndaj asaj që ata bëjnë.

146. Edhe sikur t'u sillje çdo shenjë atyre që u është dhënë Libri, prapëseprapë ata nuk do ta ndiqnin *kiblen* tënde. As ti nuk je ndjekës i *kibles* së tyre. Ata nuk ndjekin as *kiblen* e njëri-tjetrit. Po t'i ndjekësh dëshirat e tyre, edhe pse të ka ardhur dituria, patjetër që do të bëhesh ndër keqbërësit.

وَكَذَلِكَ جَعَلْنَاكُمْ أُمَّةً وَسَطًا لِتَكُونُوا  
شُهَدَاءَ عَلَى النَّاسِ وَيَكُونَ الرَّسُولُ  
عَلَيْكُمْ شَهِيدًا ۖ وَمَا جَعَلْنَا الْقِبْلَةَ الَّتِي  
كُنْتُمْ عَلَيْهَا إِلَّا لِنَعْلَمَ مَنْ يَتَّبِعُ الرَّسُولَ  
مِمَّنْ يَنْقَلِبُ عَلَى عَقْبَيْهِ ۗ وَإِنْ كَانَتْ  
لَكَبِيرَةً إِلَّا عَلَى الَّذِينَ هَدَى اللَّهُ ۗ وَمَا  
كَانَ اللَّهُ لِيُضَيِّعَ إِيمَانَكُمْ ۗ إِنَّ اللَّهَ  
بِالنَّاسِ لَرَءُوفٌ رَحِيمٌ ﴿١٤٤﴾

قَدْ نَرَى تَقَلُّبَ وَجْهِكَ فِي السَّمَاءِ ۚ  
فَلَنُؤَيِّنَنَّكَ قِبْلَةً تَرْضَاهَا ۗ فَوَلِّ وَجْهَكَ  
شَطْرَ الْمَسْجِدِ الْحَرَامِ ۗ وَحَيْثُ مَا كُنْتُمْ  
فَوُتُّوا وُجُوهَكُمْ شَطْرَهُ ۗ وَإِنَّ الَّذِينَ  
أُوتُوا الْكِتَابَ لَيَعْلَمُونَ أَنَّهُ الْحَقُّ مِنْ  
رَبِّهِمْ ۗ وَمَا اللَّهُ بِغَافِلٍ عَمَّا يَعْمَلُونَ ﴿١٤٥﴾

وَلَيْنَ آتَيْتَ الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ بِكُلِّ آيَةٍ  
مَا تَتَّبِعُوا قِبْلَتَكَ ۚ وَمَا أَنْتَ بِتَابِعٍ قِبْلَتِهِمْ ۚ  
وَمَا بَعْضُهُمْ بِتَابِعٍ قِبْلَةَ بَعْضٍ ۗ وَلَيْنَ  
آتَبْتَ أَمْوَاعَهُمْ ۗ مِنْ بَعْدِ مَا جَاءَكَ  
مِنَ الْعِلْمِ ۗ إِنَّكَ إِذَا لَمِنَ الظَّالِمِينَ ﴿١٤٦﴾

54. Mësimi i Kuranit të Shenjtë, nga cilado anë ta shohësh, mban urtësi të shumta. Ai nuk ka tepricë, e as mangësi, madje është tërësisht i baraspeshuar. Prandaj, edhe ky *umet*, pra *umeti* i Muhammedit<sup>sav</sup>, është quajtur *popull i baraspeshuar*.

147. Ata të cilëve u kemi dhënë Librin, e njohin këtë (të Dërguar, duke parë shenjat e Zotit tek ai) ashtu siç i njohin bijtë e tyre. Ka një grup të atillë prej tyre, që e fsheh të vërtetën me vetëdije.

الَّذِينَ آتَيْنَاهُمُ الْكِتَابَ يَعْرِفُونَهُ كَمَا يَعْرِفُونَ  
 آبَاءَهُمْ وَإِنَّ فَرِيقًا مِنْهُمْ لَيَكْتُمُونَ  
 الْحَقَّ وَهُمْ يَعْلَمُونَ ﴿١٤٧﴾

148. (Kjo) është e vërteta prej Zotit tënd! Pra, mos u bëj ndër dyshuesit.<sup>55</sup>

الْحَقُّ مِنْ رَبِّكَ فَلَا تَكُونَنَّ مِنَ  
 الْمُمْتَرِينَ ﴿١٤٨﴾

149. Çdokush ka një synim në të cilin është i përqendruar. Garoni në mirësi! Kudo që të gjendeni, Allahu do t'ju mbledhë bashkë. Pa dyshim, Allahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë.<sup>56</sup>

وَلِكُلِّ وِجْهَةٍ هُوَ مَوَلِيهَا فَاسْتَبِقُوا  
 الْخَيْرَاتِ إِنَّمَا تَكُونُوا يَاتٍ بِكُمْ اللَّهُ  
 جَمِيعًا إِنَّ اللَّهَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿١٤٩﴾

150. Nga cilido vend që të dalësh, drejto vëmendjen tënde kah Xhamia e shenjtë. Ajo është e vërteta prej Zotit tënd. Dhe Allahu nuk është i pavëmendshëm ndaj asaj që ju bëni.<sup>57</sup>

وَمِنْ حَيْثُ خَرَجْتَ فَوَلِّ وَجْهَكَ شَطْرَ  
 الْمَسْجِدِ الْحَرَامِ وَإِنَّهُ لَلْحَقُّ مِنْ رَبِّكَ  
 وَمَا اللَّهُ بِغَافِلٍ عَمَّا تَعْمَلُونَ ﴿١٥٠﴾

55. Konteksti tregon se ajeti nuk i drejtohet Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, pasi këtu nuk është folur për profetëri apo për Kuranin e Shenjtë, por u drejtohet besimtarëve se tani e tutje do të drejtoni fytyrën gjatë namazit kah Qabeja, në vend të Bejtul Makdisit. Allahu i Madhërishëm e thekson se kështu ishte përcaktuar qysh nga fillimi dhe se kjo është përmendur në Librat e mëparshëm si profeci, andaj – ti (o lexues i Kuranit), mos e vë në dyshim këtë pikë.

56. Në shumë pak fjalë, ky ajet tregon të gjithë përbërësit e një jete të suksesshme. Muslimani në radhë të parë duhet të vendosë për vete një synim të saktë. Më pas, duhet t'i kushtojë gjithë vëmendjen, të përqipet me të gjitha aftësitë e tij për ta arritur atë, të garojë me muslimanët e tjerë me një frymë të shëndoshë konkurrimi, dhe gjithashtu të ndihmojë edhe shokët e tij të dobët duke u bërë thirrje – ngrihuni dhe vazhdoni garën. Fjala *muvel-liha* gjithashtu do të thotë *synim të cilin e vë si prioritetin më të madh*, d.m.th. njeriu fillimisht vendos një objektiv dhe pastaj e bën atë si faktor dominues në jetën e tij. Dhe muslimanëve u thuhet – *synimi juaj më i madhi të jetë të garoni në mirësi*. Lexoni edhe 9:100.

57. Fjalët e këtij ajeti nënkuptojnë edhe profecinë se muslimanët një ditë patjetër do ta çlironin Mekën. Pra, ky çlirim i saj nga muslimanët ishte parashikuar nga Kurani jo vetëm në këtë ajet, por edhe në ajete të tjera si 17:81, 28:86 etj. Kjo profeci ishte përmendur edhe në Bibël (Ligji i Përtërirë 33:2), që u përbush në kohën kur Profeti Muhammed<sup>savs</sup>, me dhjetë mijë sahabë (*shenjtorë*) hyri në Mekë dhe e çliroi atë.

151. Nga cilido vend që të dalësh, drejto vëmendjen tënde kah Xhamia e shenjtë. Kudo që të gjendeni, kah ajo drejtoni vëmendjen tuaj, që njerëzit të mos gjejnë argument kundër jush, përveç atyre që bëjnë padrejtësi, atyre mos iu frikësoni, por frikësohuni prej Meje; që të plotësoj bekimin Tim ndaj jush e që ju të udhëzoheni.

وَمِنْ حَيْثُ خَرَجْتَ فَوَلِّ وَجْهَكَ شَطْرَ الْمَسْجِدِ الْحَرَامِ ۗ وَحَيْثُ مَا كُنْتُمْ فَوَلُّوا وُجُوهَكُمْ شَطْرَهُ ۗ لِئَلَّا يَكُونَ لِلنَّاسِ عَلَيْكُمْ حُجَّةٌ إِلَّا الَّذِينَ ظَلَمُوا مِنْهُمْ ۗ فَلَا تَخْشَوْهُمْ وَاخْشَوْنِي ۗ وَلَا تَمَّ نِعْمَتِي عَلَيْكُمْ وَلَعَلَّكُمْ تَهْتَدُونَ ﴿١٥١﴾

مصدق ١٥١

152. Ashtu siç ju kemi dërguar një të Dërguar nga mesi juaj, që ju reciton shpalljet Tona, ju pastron, ju mëson Librin dhe urtësinë dhe ju mëson ato gjëra që nuk i dinit.

كَمَا أَرْسَلْنَا فِيكُمْ رَسُولًا مِّنكُمْ يَتْلُوا عَلَيْكُمْ آيَاتِنَا وَيُزَكِّيكُمْ وَيُعَلِّمُكُمُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَيُعَلِّمُكُم مَّا لَمْ تَكُونُوا تَعْلَمُونَ ﴿١٥٢﴾

153. Prandaj, ju Më kujtoni Mua, Unë ju kujtoj ju. Më falënderoni dhe mos u bëni mosmirënjohës ndaj Meje.

فَاذْكُرُونِي أَذْكُرْكُمْ وَاشْكُرُوا لِي وَلَا تَكْفُرُونِ ﴿١٥٣﴾

١٥٣

154. O ju që besuat! Kërkojini ndihmë (Allahut) përmes durimit e namazit. Sigurisht, Allahu është me durimtarët.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اسْتَعِينُوا بِالصَّبْرِ وَالصَّلَاةِ ۗ إِنَّ اللَّهَ مَعَ الصَّابِرِينَ ﴿١٥٤﴾

155. Dhe mos i quani të vdekur ata që vriten në rrugën e Allahut. Përkundrazi, ata janë të gjallë, por ju nuk e ndieni (këtë).

وَلَا تَقُولُوا لِمَنْ يُقْتَلُ فِي سَبِيلِ اللَّهِ أَمْواتٌ ۗ بَلْ أحيَاءٌ ۗ وَلَكِنْ لَا تَشْعُرُونَ ﴿١٥٥﴾

156. Ne patjetër që do t'ju sprovovjmë duke ju përballur me pak frikë, me pak uri, me pak humbje të pasurisë, të njerëzve e të vjelave. Jepu lajm të gëzueshëm durimtarëve;<sup>58</sup>

وَلَنَبْلُوَنَّكُمْ بِشَيْءٍ مِّنَ الْخَوْفِ وَالْجُوعِ وَنَقْصٍ مِّنَ الْأَمْوَالِ وَالْأَنْفُسِ وَالثَّمَرَاتِ ۗ وَبَشِّرِ الصَّابِرِينَ ﴿١٥٦﴾

58. Ai që sprovon ose teston dikë, zakonisht nuk është i informuar për rezultatin që do të

157. të cilët kur i godet ndonjë fatkeqësi, thonë: “Sigurisht, jemi të Allahut dhe tek Ai do të kthehemi”.

الَّذِينَ إِذَا أَصَابَهُمْ مُصِيبَةٌ قَالُوا إِنَّا لِلَّهِ  
وَإِنَّا إِلَيْهِ رَاجِعُونَ ﴿١٥٧﴾

158. Mbi të tillët do të ketë bekime dhe mëshirë prej Zotit të tyre, dhe të tillët do të jenë të udhëzuar.

أُولَئِكَ عَلَيْهِمْ صَلَوَاتٌ مِّن رَّبِّهِمْ  
وَرَحْمَةٌ ۖ وَأُولَئِكَ هُمُ الْمُهْتَدُونَ ﴿١٥٨﴾

159. Safa dhe Merva<sup>59</sup> janë shenja të Allahut. Çdokush që do të bëjë *haxhin* ose *umranë* e Shtëpisë, nuk ka gjynah për të nëse sillet mes tyre. Kushdo që bën mirësi vullnetarisht, Allahu pa dyshim është Mirënjohës, i Gjithëdijshëm.

إِنَّ الصَّفَا وَالْمَرْوَةَ مِن شَعَائِرِ اللَّهِ ۚ فَمَنْ  
حَجَّ الْبَيْتِ أَوْ اعْتَمَرَ فَلَا جُنَاحَ عَلَيْهِ  
أَنْ يَّصُوفَ بِهِمَا ۖ وَمَنْ تَطَوَّعَ خَيْرًا فَإِنَّ  
اللَّهَ شَاكِرٌ عَلِيمٌ ﴿١٥٩﴾

160. Ata që fshehin diçka nga shenjat e qarta dhe nga udhëzimi që kemi zbritur, të cilën edhe ua kemi qartësuar mirë njerëzve në Libër, i mallkon Allahu dhe i mallkojnë të gjithë mallkuesit.

إِنَّ الَّذِينَ يَكْتُمُونَ مَا أَنْزَلْنَا مِنَ  
الْبَيِّنَاتِ وَالْهُدَىٰ مِنْ بَعْدِ مَا بَيَّنَّاهُ لِلنَّاسِ  
فِي الْكِتَابِ ۖ أُولَئِكَ يَلْعَنُهُمُ اللَّهُ وَيَلْعَنُهُمُ  
اللَّهُعُونَ ﴿١٦٠﴾

tregojë i testuari pas testit. Por këtu ky nuk është kuptimi i ajetit. Pra, sprova që vjen prej Zotit synon që i sprovuari të kuptojë se në çfarë gjendje jeton ai. Nëpërmjet sprovës, Zoti i zbulon njeriut të mirat dhe të këqijat e tij. Besimtari nuk i mendon sprovat si të këqija. Pikërisht sprovat janë ato që kur u bien të Dërguarve të Zotit, u sjellin lajme të mira, dhe kur u bien njerëzve të ligj, i shkatërrojnë. Ky ajet na mëson se edhe gjatë sprovës duhet ta kërkojmë pëlqimin e Allahut. Kurani ka treguar një ligj për lutjet, që nga mëshira e madhe, Zoti e trajton njeriun e mirë si shok. Pra, herë e lë dëshirën e Vet dhe atij ia plotëson lutjen, siç e tha Ai Vetë: “*M’u lutni Mua, do t’jua pranoj*” (40:61), e herë vendos sipas dëshirës së Tij, siç e pohon në këtë ajet (2:156). Ai kështu vendosi, në mënyrë që herë ta trajtojë njeriun sipas lutjes së tij, duke e bërë të përparojë në njohjen ndaj Tij, dhe herë të veprojë sipas dëshirës së Tij, duke i dhënë njeriut pëlqimin e Tij, duke e ngritur në grada në këtë botë e në tjetrën, dhe duke e bërë të përparojë në rrugët e udhëzimit, përmes dashurisë. Kurse për njeriun që nuk beson në Zot, sprova është tragjike dhe ai trembet qoftë edhe nga vështirësi të vogla. Disa syresh shohin zgjidhje vetëm në vetëvrasje. Por në të vërtetë është e domosdoshme për zhvillimin dhe edukimin e njeriut që ai të përballet me vështirësi, në mënyrë që t’i shtohet besimi në Zot.

59. Safa dhe Merva janë dy kodrina pranë Qabesë në Mekë. Këto kodra qëndrojnë si një përkujtim për durimin e madh dhe besnikërinë e jashtëzakonshme të Haxheres ndaj Zotit, nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, për kujdesin e veçantë të Zotit për të dhe djalin e saj, Ismailin. Vizita në këto kodra i nxit pelegrinit ndjenja dashurie e besnikërie ndaj Zotit dhe besimin e palëkundur në Fuqinë e Tij.

161. Përveç atyre që u penduan, u përmirësuan dhe i treguan qartë (shenjat e Allahut). Unë këtyre do t'ua pranoj pendesën. Unë jam Pendimpranuesi, Mëshirëbërësi.

162. Ata që mohuan dhe vdiqën duke qenë mohues, kanë mallkimin e Allahut, të engjëjve dhe të gjithë njerëzve.

163. Në këtë (mallkim) ata do të mbesin gjatë. Nuk do t'u pakësohet ndëshkimi dhe as nuk do t'u jepet afat.

164. I Adhureshmi juaj është i Adhureshmi i Vetëm. Nuk ka të adhureshëm tjetër përveç Atij, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

165. Pa dyshim, në krijimin e qiejve e të tokës, në ndërrimin e natës e të ditës, në anijet që lundrojnë nëpër det me ato (mjete) që u sjellin dobi njerëzve, në ujin që Allahu e zbriti prej qiellit, me të cilin e ringjalli tokën pas vdekjes së saj dhe përhapi gjithfarë shtazësh në të, po ashtu, në qarkullimin e erërave, në retë që qëndrojnë midis qiellit e tokës, ka shenja për një popull që reflekton.

166. Ndër njerëzit ka syresh që i bëjnë ortakë Allahut (dhe) i duan ashtu siç duhet ta donin Allahun. Kurse ata që besuan, e duan Allahun më shumë (se çdo gjë tjetër). Eh, sikur të kuptonin të padrejtët kur të

إِلَّا الَّذِينَ تَابُوا وَأَصْلَحُوا وَبَيَّنُّوا فَأُولَٰئِكَ أَتُوبُ عَلَيْهِمْ ۗ وَأَنَا التَّوَّابُ الرَّحِيمُ ﴿١٦١﴾

إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا وَمَاتُوا وَهُمْ كُفَّارًا ۗ أُولَٰئِكَ عَلَيْهِمْ لَعْنَةُ اللَّهِ وَالْمَلَائِكَةِ وَالنَّاسِ أَجْمَعِينَ ﴿١٦٢﴾

خُلِدِينَ فِيهَا ۗ لَا يُخَفَّفُ عَنْهُمُ الْعَذَابُ وَلَا هُمْ يُنظَرُونَ ﴿١٦٣﴾

وَاللَّهُمَّ إِلَهًا وَاحِدًا ۗ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الرَّحْمَنُ الرَّحِيمُ ﴿١٦٤﴾

إِنَّ فِي خَلْقِ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَاخْتِلَافِ أَلْوَانِ السَّمَاءِ وَالنَّهَارِ وَاللَّيْلِ فِي تَجَرُّوهُ فِي الْبَحْرِ بِمَا يَنْفَعُ النَّاسَ وَمَا أَنْزَلَ اللَّهُ مِنَ السَّمَاءِ مِنْ مَاءٍ فَأَحْيَا بِهِ الْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا وَبَثَّ فِيهَا مِنْ كُلِّ دَابَّةٍ ۗ وَتَصْرِيفِ الرِّيْحِ وَالسَّحَابِ الْمُسَخَّرِ بَيْنَ السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ لَآيَاتٍ لِّقَوْمٍ يَعْقِلُونَ ﴿١٦٥﴾

وَمِنَ النَّاسِ مَنْ يَتَّخِذُ مِنْ دُونِ اللَّهِ أَنْدَادًا يُحِبُّونَهُمْ كَحُبِّ اللَّهِ ۗ وَالَّذِينَ آمَنُوا أَشَدُّ حُبًّا لِلَّهِ ۗ وَلَوْ يَرَى الَّذِينَ ظَلَمُوا

shohin ndëshkimin, se e tërë fuqia me të vërtetë është e Allahut dhe se Allahu është shumë i rreptë në ndëshkim.

167. Kur të distancohen prijësit (devijues) prej pasuesve dhe të shohin ndëshkimin, e t'u shkëputet çdo mundësi,

168. pasuesit do të thonë: “Ah, sikur të ktheheshim një herë, do të distancoheshim edhe ne prej tyre, ashtu siç ata janë distancuar prej nesh!” Në këtë mënyrë Allahu do t'ua tregojë atyre veprat, duke ua bërë dëshpëruese dhe ata nuk kanë për të dalë prej (këtij) zjarri.

169. O njerëz! Nga ato që keni në tokë, hani (ushqime) të lejuara e të pastra, dhe mos ndiqni gjurmët e djallit!<sup>60</sup> Ai përnjëmend është armiku juaj i hapur.<sup>61</sup>

170. Ai ju urdhëron të bëni vetëm të këqija dhe imoralitete, dhe të thoni rreth Allahut atë që nuk e dini.

60. Veprat e mira duhet të shoqërojnë besimin. Nga ky ajet vërehet se fillon një diskutim për pjesën e dytë të lutjes së Ibrahim<sup>as</sup> (2:130), për misionin e Profetit të Premtuar<sup>sav</sup>, për mësimet e Sheriatit të tij dhe për urtësinë që do të gjendej në to. Në këtë sure, nga këtu e tutje janë dhënë urdhëresat rreth namazit, agjërimit, haxhit dhe zekatit dhe po ashtu ligjet që kanë të bëjnë me çështjet shoqërore. Duke qenë se ushqimi luan një rol të rëndësishëm në formimin e karakterit të njeriut, pikërisht në lidhje me të janë përmendur rregullat si fillim. Ushqimi sipas Islamit duhet të jetë: (1) *hallall*, d.m.th.. fetarisht i lejuar; dhe (2) *tajjib*, d.m.th. i mirë, i pastër, i shëndetshëm dhe i pëlqyeshëm. Sipas kriterit që përmendet në pikën 2, nganjëherë edhe ushqimi *hallall* bëhet i papëlqyeshëm.

61. Ndalimi i ndjekjes së djallit që vjen menjëherë pas urdhëresës në lidhje me ushqimin, tregon edhe ndikimin që bëjnë veprimet fizike të njeriut në gjendjen morale dhe shpirtërore të tij. Përdorimi i ushqimit jo *hallall* dhe jo *të pastër* dëmton aftësitë morale të njeriut dhe pengon zhvillimin e tij shpirtëror. Lexoni edhe 23:52.

إِذْ يَرُونَ الْعَذَابَ ۗ أَنْ الْقُوَّةَ لِلَّهِ جَمِيعًا  
وَأَنَّ اللَّهَ شَدِيدُ الْعَذَابِ ﴿١٦٧﴾

إِذْ تَبَرَّأَ الَّذِينَ اتَّبَعُوا مِنَ الَّذِينَ  
اتَّبَعُوا وَرَأَوْا الْعَذَابَ وَتَقَطَّعَتْ بِهِمُ  
الْأَسْبَابُ ﴿١٦٧﴾

وَقَالَ الَّذِينَ اتَّبَعُوا لَوْ أَنَّا كُنَّا كَرَّةً فَتَبَرَّأْنَا  
مِنْهُمْ كَمَا تَبَرَّءُوا مِنَّا ۗ كَذَلِكَ يُرِيهِمُ  
اللَّهُ أَعْمَالَهُمْ حَسْرَتٍ عَلَيْهِمْ ۗ وَمَا هُمْ  
بِخَارِجِينَ مِنَ النَّارِ ﴿١٦٧﴾

يَا أَيُّهَا النَّاسُ كُلُوا مِمَّا فِي الْأَرْضِ حَلَّالًا  
طَيِّبًا ۗ وَلَا تَتَّبِعُوا خُطُوَاتِ الشَّيْطَانِ ۗ إِنَّهُ  
لَكُمْ عَدُوٌّ مُبِينٌ ﴿١٦٩﴾

إِنَّمَا يَأْمُرُكُمْ بِالسُّوءِ وَالْفَحْشَاءِ ۗ وَأَن  
تَقُولُوا عَلَى اللَّهِ مَا لَا تَعْلَمُونَ ﴿١٧٠﴾



171. Dhe kur atyre u thuhet: “Ndiqni atë që zbriti Allahu”, ata thonë: “Jo! Do ta ndjekim atë, në të cilën kemi gjetur të parët tanë”. Vallë, edhe sikur të parët e tyre nuk kuptonin asgjë dhe nuk ishin të udhëzuar, (prapë, ata do t’i ndiqnin)?!<sup>62</sup>

172. Shembulli i atyre që mohuan është si ai që thërret me të madhe dikë që nuk dëgjon; (veprimi i tyre) është veçse një klithmë a thirrme. Janë të shurdhër, memecë, të verbër, prandaj nuk kuptojnë.<sup>63</sup>

173. O ju që besuat! Hani gjërat e pastra, nga ato që ju kemi dhënë dhe falënderojeni Allahun, nëse e adhuron vetëm Atë.

174. Ai ju ka ndaluar vetëm ngordhësirën, gjakun, mishin e derrit dhe atë që është therur a blatur në emër të dikujt tjetër përveç Allahut. Por ai që detyrohet tej mase dhe që nuk është as lakmues e as shkelës i kufijve, nuk bën mëkat. Allahu, pa dyshim, është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

175. Ata që fshehin ndonjë gjë nga Libri, të cilin Allahu e zbriti, dhe e

وَإِذَا قِيلَ لَهُمُ اسْمِعُوا مَآ أَنْزَلَ اللَّهُ قَالُوا بَلْ نَسْمَعُ مَآ أُنزِلْنَا عَلَيْهِ أَبَآءُنَا أَوْ لَوْ كَانَ أَبَاؤُهُمْ لَا يَعْقِلُونَ شَيْئًا وَلَا يَهْتَدُونَ ﴿٧١﴾

وَمَثَلُ الَّذِينَ كَفَرُوا كَمَثَلِ الَّذِي يَنْعِقُ بِمَا لَا يَسْمَعُ إِلَّا دُعَاءً وَ نِدَاءً صُمٌّ بُكْمٌ عُمْى فَهُمْ لَا يَعْقِلُونَ ﴿٧٢﴾

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُلُوا مِن طَيِّبَاتِ مَا رَزَقْنَاكُمْ وَاشْكُرُوا لِلَّهِ إِن كُنتُمْ إِيَّاهُ تَعْبُدُونَ ﴿٧٣﴾

إِنَّمَا حَرَّمَ عَلَيْكُمُ الْمَيْتَةَ وَالدَّمَ وَلَحْمَ الْخَنزِيرِ وَمَا أَهَلَ بِهِ نَغِيرِ اللَّهِ ؕ فَمَن اضْطُرَّ غَيْرَ بَاغٍ وَوَلَا عَادٍ فَلَا إِثْمَ عَلَيْهِ ؕ إِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَّحِيمٌ ﴿٧٤﴾

إِنَّ الَّذِينَ يَكْتُمُونَ مَآ أَنْزَلَ اللَّهُ مِن الْكِتَابِ وَيَشْتَرُونَ بِهِ ثَمَنًا قَلِيلًا أُولَٰئِكَ

62. Sa e çuditshme aq edhe fatkeqe është për njeriun që pikërisht në çështjen e besimit, e cila ndikon thellë në të gjithë jetën e tij, edhe të kësaj bote, edhe të botës tjetër, shpesh ai mjaftohet duke ndjekur verbërisht gjurmët e të parëve të tij! Kurse në çështjet e botës ku i rrezikohen vetëm interesat materiale, edhe ato jo gjithmonë, ai kujdeset me përpikëri që të ndjekë rrugën e duhur dhe të mos i ndjekë të tjerët verbërisht. Ky fakt përmendet shpesh në Kuranin e Shenjtë, sepse pikërisht për shkak të këtij mentaliteti, shumica e njerëzve nuk guxojnë ta pranojnë të vërtetën që u vjen prej Zotit.

63. D.m.th. inati ua zbehu aftësitë pozitive, andaj ata nuk arrijnë ta shqyrtojnë të vërtetën.

këmbejnë atë me një çmim të vogël,<sup>64</sup> asgjë nuk gëlltisin në barkun e tyre përveç zjarrit dhe, Ditën e Kiametit, atyre Allahu as nuk do t'u flasë, as nuk do t'i pastrojë, dhe ata do të kenë ndëshkim të dhimbshëm.

176. Të tillët janë ata që këmbyen udhëzimin me devijimin dhe faljen me ndëshkimin. Eh, sa do ta durojnë zjarrin ata!

177. Kështu do të jetë, sepse Allahu e zbriti Librin me të vërtetën. Kurse ata që kundërshtuan (njëri-tjetrin) në lidhje me Librin, pa dyshim, kanë rënë në ndasi të skajshme.

178. Mirësi nuk është të ktheni fytyrat tuaja nga Lindja apo Perëndimi, por mirësi i cilësohet atij<sup>65</sup> që beson Allahun, Ditën e *Ahiretit*, engjëjt, Librin dhe Profetët; që, duke pasur dashuri ndaj Tij,<sup>66</sup> u jep pasuri të afërmve, jetimëve, të varfërve, udhëtarëve, lypësve, dhe për lirim të robëruarve; që fal namazin dhe jep zekatin; (mirësia është e atyre) që përmbushin premtimin kur premtojnë, që janë të durueshëm gjatë vështirësive,

مَا يَأْكُلُونَ فِي بُطُونِهِمْ إِلَّا النَّارَ وَلَا  
يُكَلِّمُهُمُ اللَّهُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ وَلَا يُزَكِّيهِمْ  
وَلَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿٧٦﴾

أُولَئِكَ الَّذِينَ اشْتَرُوا الضَّلَالََةَ بِالْهُدَى  
وَالْعَذَابَ بِالْمَغْفِرَةِ ۖ فَمَا أَصْبَرَهُمْ عَلَى  
النَّارِ ﴿٧٧﴾

ذَلِكَ بِأَنَّ اللَّهَ نَزَّلَ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ ۗ وَإِنَّ  
الَّذِينَ اخْتَلَفُوا فِي الْكِتَابِ لَفِي شِقَاقٍ  
بَعِيدٍ ﴿٧٨﴾

لَيْسَ الْبِرَّ أَنْ تُوْتُوا وُجُوهَكُمْ قِبَلَ  
الْمَشْرِقِ وَالْمَغْرِبِ وَلَكِنَّ الْبِرَّ مَنْ آمَنَ  
بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ وَالْمَلَائِكَةِ وَالْكِتَابِ  
وَالنَّبِيِّينَ ۗ وَآتَى الْمَالَ عَلَى حُبِّهِ ذَوِي  
الْقُرْبَىٰ وَالْيَتَامَىٰ وَالْمَسْكِينِ وَابْنَ السَّبِيلِ ۗ  
وَالسَّالِفِينَ ۗ وَفِي الرِّقَابِ ۗ وَأَقَامَ الصَّلَاةَ  
وَآتَى الزَّكَاةَ ۗ وَالْمُؤْتُونَ بِعَهْدِهِمْ إِذَا  
عَاهَدُوا ۗ وَالصَّابِرِينَ فِي الْبَأْسَاءِ وَالضَّرَّاءِ

64. Kurani përmend *çmim të vogël*, dhe kjo nuk do të thotë se mund bësh një gjë të tillë për një çmim të madh, por do të thotë se vlera materiale sado e madhe qoftë, nëse merret në këmbim të besimit, ajo nuk vlen.

65. Për këtë kuptim të fjalës *el-birr*, i referohemi librit të kuptimeve të Kuranit "*Imlau ma men-na bihir-Rrahman*".

66. Në fjalët *duke pasur dashuri ndaj tij* (arab. *ala hubbihi*), përmri *tij* (arab. *hi*) gjuhësisht mund t'i referohet edhe Allahut, edhe pasurisë. Në rastin e parë kuptimi i fjalës është ai që kemi lënë në përkthimin e ajetit, kurse në rastin e dytë, përkthimi do të jetë: "*pavarësisht nga dashuria për pasurinë, e shpenzojnë atë për të afërmit, jetimët ...*".

brengave dhe gjatë luftës. Pikërisht këta janë që përvetësojnë të vërtetën dhe pikërisht këta janë të druajturit (ndaj Zotit).

179. O ju që besuat! Ju është bërë e obligueshme hakmarrja e barabartë në lidhje me të vrarët: i liri sa një i lirë, skllavi sa një skllav dhe femra sa një femër.<sup>67</sup> Ndërsa, ai që i falet diçka prej vëllait të tij, duhet të sillet sipas rregullit e t'ia shpaguajë me mirësi. Kjo prej Zotit tuaj është lehtësi dhe mëshirë. Kurse ai që e tepron edhe pas kësaj, do të ketë ndëshkim të dhimbshëm.

180. Në (sistemin) e hakmarrjes së barabartë ka jetë për ju, që të përmbaheni, o të mençur.<sup>68</sup>

181. Prej jush atij që i afrohet vdekja dhe që ka edhe pasuri, i obligohet që në mënyrë të drejtë ta lërë testamentin për prindërit dhe të afërmit. Është e detyrueshme për ata që druhen (ndaj Zotit).

182. Kushdo që e ndryshon, pasi e ka dëgjuar, (ta dijë) se mëkati është përmbi ata që e ndryshojnë. Sigurisht, Allahu është Gjithëdhëgues, i Gjithëdijshëm.

وَحِينَ الْبَاسِ ۗ أُولَٰئِكَ الَّذِينَ صَدَقُوا  
وَأُولَٰئِكَ هُمُ الْمُتَّقُونَ ﴿٧٩﴾

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كَتَبَ عَلَيْكُمُ الْقِصَاصَ  
فِي الْقَتْلِ ۗ أَلْحَرُّ بِالْحَرِّ وَالْعَبْدُ بِالْعَبْدِ  
وَالْأُنثَىٰ بِالْأُنثَىٰ ۗ فَمَنْ عَنَىٰ لَهُ مِنْ  
أَخِيهِ شَيْءٌ فَاتِّبَاعٌ بِالْمَعْرُوفِ وَأَدَاءٌ  
إِلَيْهِ بِإِحْسَانٍ ۗ ذَٰلِكَ تَخْفِيفٌ مِّن رَّبِّكُمْ  
وَرَحْمَةٌ ۗ فَمَنِ اعْتَدَىٰ بَعْدَ ذَٰلِكَ فَلَهُ  
عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿٧٩﴾

وَلَكُمْ فِي الْقِصَاصِ حَيٰوةٌ يَا أُولِي الْأَلْبَابِ  
لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ ﴿٨٠﴾

كُتِبَ عَلَيْكُمُ إِذَا حَضَرَ أَحَدَكُمُ الْمَوْتُ  
إِنْ تَرَكَ خَيْرًا ۗ الْوَصِيَّةُ لِلْوَالِدَيْنِ  
وَ الْأَقْرَبِينَ بِالْمَعْرُوفِ ۗ حَقًّا عَلَى  
الْمُتَّقِينَ ﴿٨١﴾

فَمَنْ بَدَّلَهُ بَعْدَ مَا سَمِعَهُ فَإِنَّمَا إِثْمُهُ  
عَلَى الَّذِينَ يَبَدِّلُونَهُ ۗ إِنَّ اللَّهَ سَمِيعٌ  
عَلِيمٌ ﴿٨٢﴾

67. D.m.th. nëse një njeri i lirë vret dikë, qoftë ky i lirë, skllav, grua apo burrë, haku merret vetëm ndaj autorit, pra ndaj njeriut të lirë i cili ka kryer vrasje. Po kështu, nëse vrasësi është skllav, po atij skllavi i duhet marrë haku.

68. Sipas Kuranit të Shenjtë, me hakmarrjen e barabartë, ulet numri i vrasjeve dhe njerëzit përmirësohen, megjithatë askush nuk ka të drejtë të hakmerret duke bërë vetëgjyqësi. Në kohën e Profetit<sup>savs</sup>, vendoste Profeti<sup>savs</sup>, dhe në kohën e Kalifëve të tij të Drejtë, vendosnin Kalifët<sup>ra</sup> me drejtësi dhe paanësi.

183. Ai që dyshon te testamentbërësi për njëanshmëri a mëkat dhe bën pajtim midis tyre (pra, midis trashëgimtarëve), nuk bën gjynah. Sigurisht, Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

فَمَنْ خَافَ مِنْ مُؤَسِّسٍ أَوْ إِمَامٍ  
فَأَصْلَحَ بَيْنَهُمْ فَلَا إِثْمَ عَلَيْهِ ۗ إِنَّ اللَّهَ  
عَفُورٌ رَحِيمٌ ﴿٢٤٠﴾

184. O ju që besuat! Ju obligohen agjërimit ashtu siç u ishin obliguar atyre që ishin para jush, që të bëheni të druajtur (ndaj Zotit).

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الصِّيَامُ  
كَمَا كُتِبَ عَلَى الَّذِينَ مِنْ قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ  
تَتَّقُونَ ﴿٢٤١﴾

185. Janë pak ditë të numëruara. Kushdo që është i sëmurë prej jush, ose që gjendet në udhëtim, le ta plotësojë numrin në ditë të tjera.<sup>69</sup> Ata që kanë mundësi,<sup>70</sup> le të ushqejnë një të varfër si shpagim. Kushdo që bën mirësi shtesë, bën mirë për veten e tij. Dhe nëse agjëroni, kjo është mirë për ju, në qoftë se e dini.<sup>71</sup>

أَيَّامًا مَعْدُودَاتٍ ۗ فَمَنْ كَانَ مِنْكُمْ مَرِيضًا  
أَوْ عَلَى سَفَرٍ فَعِدَّةٌ مِنْ أَيَّامٍ أُخَرَ ۗ وَعَلَى  
الَّذِينَ يُطِيقُونَهُ فِدْيَةٌ طَعَامِ مِسْكِينٍ ۗ  
فَمَنْ تَطَوَّعَ خَيْرًا فَهُوَ خَيْرٌ لَّهُ ۗ وَأَنْ  
تَصُومُوا خَيْرٌ لَكُمْ إِنْ كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ ﴿٢٤٢﴾

69. Udhëtari që agjëron, dëshiron të fitojë pëlqimin e Zotit me forcën e krahut të tij e jo me bindje ndaj Zotit, kurse besimi i vërtetë qëndron në bindjen ndaj fjalës së Zotit. Kush quhet udhëtar? Çdokush që bën një udhëtim qoftë të vogël apo të madh, por që te njerëzit në përgjithësi quhet udhëtim, është udhëtar. *Veprat varen nga qëllimi* (Buhari, nr. 1). Kur robi përgatitet, merr çantën a valixhen dhe nisat për një rrugë, ai është udhëtar. Urdhri i Kuranit nuk është i bazuar te distanca e udhëtimit, por te termi i përgjithshëm që quhet udhëtim. Dhe meqë prej Zotit kanë ardhur edhe urdhri i agjërimin, edhe lehtësia, atëherë mirësia për robin qëndron në zbatimin e asaj që thotë Zoti.

70. Në këtë ajet, folja *jutikunehu* ka të dyja kuptimet: *ata që kanë mundësi*, po ashtu *ata që nuk kanë mundësi*, sepse është një folje që në arabisht ka edhe kuptimin pohues, edhe atë mohues. Për këtë arsye, ajeti mund të ketë dy kuptime: (1) ata që nuk mund të agjërojnë për shkak të ndonjë sëmundjeje apo vështirësie të përkohshme, por më vonë mund të bëhen të aftë të agjërojnë, duhet të japin shpagimin, por më pas edhe duhet të agjërojnë; (2) ata që nuk kanë fare mundësi të agjërojnë, le të mjaftohen duke dhënë shpagimin.

71. Muaji i Ramazanit është shumë i dobishëm për ndriçimin e zemrës. Namazi ia pastron shpirtin dhe agjërimi ia ndriçon zemrën. Pastrim i shpirtit do të thotë që njeriu të fitojë largësinë nga epshet e *nefsit amarah* (që nxit për të keqen, 12:53) dhe ndriçim i zemrës do të thotë që atij t'i hapet dera e vizionit (e *keshfit*), në mënyrë që ta shohë Zotin. Agjërimi nuk është vetëm që njeriu të rrijë pa bukë e pa ujë, madje agjërimi ka një përjetim dhe ndikim, që njeriu e kupton nga përvoja. Është në natyrën e njeriut që sa më pak të ushqehet, aq më shumë i pastrohet *nefsi*, dhe i shtohen edhe forcat për të pasur komunikimin Hyjnor. Me agjërimin Zoti dëshiron që njeriu të pakësojë njërin ushqim, dhe të shtojë ushqimin tjetër, shpirtërorin.

186. Muaji Ramazan është ai në të cilin u zbrit Kurani si udhërrëfyes për njerëzit dhe me shenjat e qarta, që përbëhen nga shpjegimet e udhëzimit dhe çështjet dalluese (të së vërtetës nga e rrema). Kushdo nga ju që dëshmon këtë muaj, le të agjërojë në të. Kurse ai që është i sëmurë, ose që gjendet në udhëtim, le të plotësojë numrin në ditë të tjera. Allahu do lehtësi për ju dhe nuk do vështirësi për ju dhe do që ju (lehtësisht) ta plotësoni numrin e ditëve, ta madhëroni Allahun për atë që ju udhëzoi dhe që të bëheni mirënjohës.

187. Kur robërit e Mi të pyesin rreth Meje, Unë pa dyshim jam afër. I përgjigjem lutjes së lutësit, kur ai Më lutet. Prandaj, edhe ata le t'i përgjigjen thirrjes Sime dhe le të më besojnë Mua, që të udhëzohen.<sup>72</sup>

188. Ju lejohet që, gjatë netëve (të muajit) të agjërimëve, të bëni marrëdhënie me gratë tuaja. Ato janë petk për ju dhe ju jeni petk për

شَهْرُ رَمَضَانَ الَّذِي أُنزِلَ فِيهِ الْقُرْآنُ  
هُدًى لِّلنَّاسِ وَبَيِّنَاتٍ مِّنَ الْهُدَى  
وَ الْفُرْقَانِ ۚ فَمَنْ شَهِدَ مِنْكُمُ الشَّهْرَ  
فَلْيَصُمْهُ ۗ وَمَنْ كَانَ مَرِيضًا أَوْ عَلَى سَفَرٍ  
فَعِدَّةٌ مِّنْ أَيَّامٍ أُخَرَ ۗ يُرِيدُ اللَّهُ بِكُمُ  
الْيُسْرَ وَلَا يُرِيدُ بِكُمُ الْعُسْرَ ۗ وَتُكْمِلُوا  
الْعِدَّةَ ۗ وَتُكْبِّرُوا اللَّهَ عَلَى مَا هَدَاكُمْ  
وَلَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ ﴿١٨٦﴾

وَ إِذَا سَأَلَكَ عِبَادِي عَنِّي فَإِنِّي قَرِيبٌ ۗ  
أَجِبْ دَعْوَةَ الدَّاعِ إِذَا دَعَا ۗ فَلْيَسْتَجِيبُوا  
لِي وَليُؤْمِنُوا بِإِلْعَاقِهِمْ يُرْسِدُونَ ﴿١٨٧﴾

أَجَلٌ لَّكُمْ لَيْلَةَ الصِّيَامِ الرَّفَثُ إِلَى  
نِسَائِكُمْ ۗ هُنَّ لِبَاسٌ لَّكُمْ وَأَنْتُمْ لِبَاسٌ  
لَّهُنَّ ۗ عَلِمَ اللَّهُ أَنَّكُمْ كُنْتُمْ تَخْتَانُونَ

Agjërimi gjithashtu është shumë i dobishëm edhe për shëndetin.

72. Nuk ka Profet në botë që nuk dha mësimin e lutjes. Pikërisht lutja është ajo që krijon lidhje mes robit dhe Zotit. Është e vështirë të hedhësh hap në këtë rrugë, por kur e hedh, lutja të bëhet zgjidhja e çdo vështirësie të jetës. Ai që mohon lutjen, e mohon Zotin. Por vetëm lutja nuk mjafton, pasi qëllimi i Zotit është që robi të përdorë të gjitha mjetet, të bëjë të gjitha përpjekjet dhe gjithashtu edhe të lutet. Të bësh vetëm lutjen dhe të mos përpiqesh është njësoj si ta sprovosh Zotin. Lutja duhet bërë jo thjesht me fjalë të thata, por me emocion, dhe për këtë arsye, të duhet që përveç lutjeve të praktikuar nga Profeti<sup>savs</sup>, të bësh lutje edhe në gjuhën tënde, sepse të pasurit emocion në lutje gjithashtu është praktikë e Profetit<sup>savs</sup>. Zoti dëshiron që ne të krijojmë një lidhje me Të. Pa e krijuar këtë lidhje, nuk mund ta bëjmë dot lutjen. Dhe lidhja me Zotin nuk mund të krijohet duke bërë një jetë të shkujdesur e duke përsëritur ca fjalë të njëjta. Lidhja me Zotin kërkon përqendrim.

to.<sup>73</sup> Allahu e di që ju bënit padrejtësi ndaj vetes,<sup>74</sup> prandaj, Ai jua pranoi pendesën duke ju mëshiruar dhe ju fali. Kështu që, tani e tutje, shkoni me to (pa ngurrim) dhe kërkoni atë që ka shkruar Allahu për ju. Dhe hani e pini, derisa prej sabahut, t'ju dallohet fija e bardhë (e agimit) nga fija e zezë (e natës).<sup>75</sup> Pastaj, plotësojeni agjërimin deri në mbrëmje. Mos kryeni marrëdhënie me to kur jeni duke bërë *itikaf*<sup>76</sup> në xhami. Këta janë kufijtë e Allahut, andaj, mos iu afroni atyre! Kështu Allahu ua shpjegon qartë *ajetet* e Tij njerëzve, që ata të fitojnë druajtje.

189. Mos gëlltitni pasuritë e njëritjetrit me gënjeshtër e mashtrim dhe as mos i çoni deri tek autoritetet me qëllim që të gëlltisni ligësisht e me vetëdije diçka nga pasuritë e njerëzve (pra, të pullit).<sup>77</sup>

أَنْفُسَكُمْ فَتَابَ عَلَيْكُمْ وَعَفَا عَنْكُمْ ۗ  
فَأَنْتُمْ بِأَسْرُوهِنَّ وَأَبْتَعُوا مَا كَتَبَ اللَّهُ  
لَكُمْ ۖ وَكُلُّوا وَاشْرَبُوا حَتَّىٰ يَتَبَيَّنَ لَكُمُ  
الْخَيْطُ الْأَبْيَضُ مِنَ الْخَيْطِ الْأَسْوَدِ مِنَ  
الْأَفْجْرِ ۗ ثُمَّ أَتَمُّوا الصِّيَامَ إِلَى الْآيِلِ ۗ وَلَا  
تُبَاشِرُوهُنَّ وَأَنْتُمْ عَاكِفُونَ ۗ فِي الْمَسْجِدِ  
تِلْكَ حُدُودُ اللَّهِ فَلَا تَقْرَبُوهَا ۗ كَذَلِكَ  
يُبَيِّنُ اللَّهُ آيَاتِهِ لِلنَّاسِ لَعَلَّهُمْ يَتَّقُونَ ﴿١٨٩﴾

وَلَا تَأْكُلُوا أَمْوَالَكُمْ بَيْنَكُمْ بِالْبَاطِلِ  
وَتَذَلُّوا بِهَا إِلَى الْحُكَّامِ لِتَأْكُلُوا فَرِيقًا  
مِّنْ أَمْوَالِ النَّاسِ بِالْإِثْمِ وَأَنْتُمْ  
تَعْلَمُونَ ﴿١٩٠﴾

73. Diku tjetër në Kuran, vetë Zoti ka përshkruar dobisë e veshjes duke thënë se ato ju mbulojnë të turpshmet, ju zbukurojnë (7:27), ju ruajnë nga ndikimet e klimës dhe ju mbrojnë nga sulmet (16:82). Nisur nga këto kuptime, fjala *veshje* ose *petk* në këtë ajet tregon se qëllimi i lidhjes bashkëshortore nuk është vetëm kënaqësia seksuale, por se burri dhe gruaja t'i sigurojnë njëritjetrit qetësinë, mbulimin e të metave, zbukurimin, mbrojtjen nga çdo ndikim negativ dhe nga çdo sulm. Përveç kësaj, ky ajet shpjegon edhe statusin e gruas në familje.

74. Me fjalët “*ju bënit padrejtësi ndaj vetes*”, do të thotë se sahabët<sup>73</sup> në përgjithësi ruheshin nga marrëdhëniet bashkëshortore edhe gjatë netëve të Ramazanit, të cilat, në këtë ajet, Zoti ua lejoi, por ua ndaloi vetëm gjatë *itikafit*, siç shprehet në vazhdim të ajetit.

75. Fija e bardhë të dallohet nga fija e zezë nuk do të thotë se njeriu të marrë fije të tilla e t'i shohë gjatë natës nëse ato dallohen nga njëra-tjetra apo jo, por do të thotë se koha e mbarimit të syfyrit është atëherë kur bardhësia e agimit fillon të dallohet.

76. *Itikafi* është mbyllja në xhami ose në ndonjë vend të veçantë, për të adhuruar Allahun ditë e natë, duke u shkëputur nga punët e botës. Ky adhurim intensiv veçanërisht bëhet në dhjetëditëshin e fundit të muajit të bekuar të Ramazanit.

77. Porosia për të agjëruar i obligoi muslimanët të përmbahen nga ngrënia, pirja dhe kënaqësia trupore gjatë një kohe të caktuar, me synimin për të fituar pëlqimin e Zotit dhe për të arritur druajtje e devotshmëri ndaj Tij. Ky ishte momenti më i përshtatshëm për të na kujtuar se nuk është e mjaftueshme që thjesht të agjërojmë duke ndenjur pa bukë e pa ujë, por duhet

190. Ata të pyesin ty rreth hënave të tri netëve të para. Thuaj: Ato janë mjete të përcaktimit të kohës për njerëzit, gjithashtu edhe (të përcaktimit) të haxhit.<sup>78</sup> Mirësi nuk është që ju të hyni në shtëpi nga mbrapa, por mirësi është vetëm e atij që ka druajtje. Hyni pra, në shtëpi nga dyert e tyre. Kini druajtje ndaj Allahut, që të gëzoni sukses.

يَسْأَلُونَكَ عَنِ الْأَهْلِ قُلْ هِيَ مَوَاقِيتُ  
لِلنَّاسِ وَالْحَجِّ وَلَيْسَ الْبِرُّ بِأَنْ تَأْتُوا  
الْبُيُوتَ مِنْ ظُهُورِهَا وَلَكِنَّ الْبِرَّ مِنَ  
التَّقَىٰ وَأَتُوا الْبُيُوتَ مِنْ أَبْوَابِهَا ۚ وَاتَّقُوا  
اللَّهَ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ ﴿١٩٠﴾

191. Luftoni në rrugën e Allahut me ata që luftojnë me ju dhe mos e teproni. Njëmend, Allahu nuk i do ata që e teprojnë.<sup>79</sup>

وَقَاتِلُوا فِي سَبِيلِ اللَّهِ الَّذِينَ يُقَاتِلُونَكُمْ  
وَلَا تَعْتَدُوا ۗ إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ الْمُعْتَدِينَ ﴿١٩١﴾

192. Dhe (gjatë luftës) vritini ata kudo që t'i gjeni, dhe dëbojini prej atje, siç ata ju dëbuan ju. Persekutimi është më i rëndë se vrasja.<sup>80</sup> Mos luftoni me ta pranë Xhamisë së shenjtë, derisa ata të luftojnë me ju atje. Pra, nëse ata luftojnë me ju,

وَأَقْتُلُوهُمْ حَيْثُ ثَقِفْتُمُوهُمْ وَأَخْرِجُوهُمْ  
مِنْ حَيْثُ أَخْرَجُوكُمْ وَالْفِتْنَةُ أَشَدُّ مِنَ  
الْقَتْلِ ۗ وَلَا تُقَاتِلُوهُمْ عِنْدَ الْمَسْجِدِ الْحَرَامِ  
حَتَّىٰ يُقَاتِلُوكُمْ فِيهِ ۚ فَإِنْ قَاتَلُوكُمْ

që kurrë të mos hamë ryshfetin, të mos i gllabërojmë pasurinë askujt dhe të mos i hyjmë në hak asnjërit. Për ata që i gllabërojnë pasurinë tjetrit, që bëjnë një jetë të gënjeshtërt, Profeti<sup>savs</sup> thotë: Allahut nuk i duhet që ata të rrinë pa bukë e pa ujë (Buhari, nr. 1903).

78. Për matjen e kohës, feja Islame ka përdorur si sistemin hënor, ashtu edhe sistemin diellor. Për matjen e kohës gjatë adhurimeve ditore, qoftë për namazet e pesë vakteve, qoftë për fillimin dhe mbarimin e agjërimit, ka përdorur sistemin diellor. Kurse për adhurimet që kryhen brenda një muaji të caktuar, për zgjedhjen e muajit të agjërimit, për caktimin e kohës së Haxhit, etj., ka përdorur sistemin hënor.

79. Ky është një nga ajetet më të hershme ku Zoti u dha muslimanëve lejen për të luftuar. Ajeti i parë që solli këtë leje ishte 22:40. Në thelb, ky ajet i sures El-Bekare tregon kushtet, të cilave një luftë e armatosur fetare duhet t'u përmbahet, dhe ato janë: (a) të synojë heqjen e pengesave që kundërshtarët u kanë vendosur në rrugën e Allahut, pra të synojë vendosjen e lirisë së fesë dhe të besimit; (b) lufta të bëhet vetëm kundër atyre, të cilët sulmuan të parët kundër muslimanëve; dhe (c) muslimanët duhet të heqin dorë nga lufta, sapo armiku të tërhiqet nga ajo, pasi Allahu nuk i do ata që e teprojnë. Lexoni edhe 25:53.

80. Ky ajet vjen në kontekst kur lufta ka shpërthyer me të gjitha përmasat e saj. Natyrisht, kjo porosi është vetëm kundër atyre, të cilët të parët e ndezën luftën, dhe më pas, vranë njerëz të pafajshëm dhe bënë krime lufte.

vrutini. I tillë është ndëshkimi për mohuesit.

193. Nëse ata tërhiqen, atëherë Allahu, pa dyshim, është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

194. Luftoni kundër tyre, derisa të mos mbetet trazirë dhe feja të bëhet për Allahun.<sup>81</sup> Pra, nëse ata tërhiqen, atëherë nuk duhet të shtrëngoni askënd, përveç atyre që janë mizorë.<sup>82</sup>

195. (Çnderimi në) muajin e shenjtë (mund të hakmerret) në muajin e shenjtë dhe për (të gjitha) të shenjtat (e çnderuara) ka hakmarrje. Pra, kushdo që ju shtyp, edhe ju shtypeni atë ashtu siç ai ju ka shtypur ju. Kini druajtje ndaj Allahut dhe dijeni se Allahu është me të druajturit.<sup>83</sup>

فَأَقْتُلُوهُمْ ۗ كَذَلِكَ جَزَاءُ الْكٰفِرِيْنَ ۝۱۹۳

فَإِنِ اتَّهَمُوا فَإِنَّ اللَّهَ غَفُوْرٌ رَّحِيْمٌ ۝۱۹۴

وَقَاتِلُوهُمْ حَتَّى لَا تَكُوْنَ فِتْنَةٌ وَيَكُوْنَ  
الدِّيْنُ لِلَّهِ فَإِنِ اتَّهَمُوا فَلَا عُدُوَانَ إِلَّا  
عَلَى الظَّٰلِمِيْنَ ۝۱۹۵

الشَّهْرُ الْحَرَامُ بِالشَّهْرِ الْحَرَامِ وَالْحُرُمٰتُ  
قِصَاصٌ ۗ فَمَنْ اَعْتَدٰى عَلَيْكُمْ فَاَعْدُوْا  
عَلَيْهِ بِمِثْلِ مَا اَعْتَدٰى عَلَيْكُمْ ۗ وَاتَّقُوا  
اللَّهَ وَاعْلَمُوْا اَنَّ اللَّهَ مَعَ الْمُتَّقِيْنَ ۝۱۹۶

81. Edhe ky ajet e thekson se muslimanëve iu lejua të luftonin vetëm për vetëmbrojtje, dhe ta vijonin luftën derisa të vendosej plotësisht liria fetare. Ka komentues që interpretojnë fjalën arabe *fitne* (trazirë) si *idhujtari* dhe më pas justifikojnë se gjoja Kurani i lejuaka të luftojnë të gjithë jomuslimanët derisa të largohet idhujtaria nga faqja e dheut. Ky nuk është aspak kuptimi i ajetit. Po të ishte kështu, Profeti Muhammed<sup>savs</sup> nuk do të mund të kishte lidhur një sërë traktatesh paqeje me jobesimtarët. Realisht, ky ajet porositi të kundërtën, që lufta të bëhej vetëm derisa feja dhe çështja e fesë të mos ishte më në dorën e njerëzve, të cilët i persekutonin ashpër muslimanët, por të ishte tërësisht në dorën e Allahut. Këtë mesazh e jep në mënyrë të theksuar edhe ajeti 22:40 dhe 2:257.

82. Këto katër ajete (191-194) përmbajnë disa kushte për muslimanët për të bërë xhihadin me armë, që janë: a) lufta fetare të bëhej vetëm për hir të Zotit dhe për asnjë motiv personal; (b) muslimanëve iu lejua të luftonin vetëm kundër atyre, të cilët e bënë të parët sulmin; (c) edhe në rastin kur armiku i sulmoi i pari, muslimanët ishin të obliguar të mos i kalonin limitet dhe të mos e përhapnin atë përtej objektivit të nevojshëm; (ç) ata ishin të obliguar të luftonin vetëm kundër ushtrisë dhe jo kundër njerëzve civilë dhe të pambrojtur; (d) gjatë luftës duhej t'u mundësonin imunitet nga lufta të gjitha ceremonive dhe riteve fetare; (dh) lufta në një vend të shenjtë të ishte tërësisht e ndaluar, madje as në rrethinat e tij; (e) muslimanët mund të luftonin në një vend të shenjtë ose në rrethinat e tij vetëm kur armiku ta përdorte atë si bazë të tij për luftë; (ë) luftën ta vijonin për aq kohë sa të siguronin lirinë fetare. Lexoni edhe 8:40; 9:4-6; 22:40.

83. Muajt e shenjtë janë Dhul Kade, Dhul Hixhe, Muharrem dhe Rexheb (Buhari, nr. 3197).



196. Shpenzoni në rrugën e Allahut dhe mos e shpini (veten) në shkatërrim me duart tuaja. Bëni mirësi. Me të vërtetë, Allahu i do mirëbërësit.

197. Plotësoni *haxhin* dhe *umranë*<sup>84</sup> për hir të Allahut.<sup>85</sup> Nëse do të pengoheni, thorni çfarëdolloj kurban qe gjeni. Dhe mos i ruani kokat tuaja, derisa kurban të arrijë në vendin e tij (të therjes). Kushdo nga ju që është i sëmurë ose ka ndonjë shqetësim në kokë, le të japë shpagim në formë agjërimesh ose lëmoshe ose kurban. E kur të gëzoni paqe, kushdo që dëshiron të përfitojë nga bashkimi i *umrasë* me *haxhin*, le të therë kurban sipas mundësisë. Dhe nëse nuk gjen ndonjë, le të agjërojë tri ditë gjatë haxhit dhe shtatë të tjera kur të kthehet. Ja, dhjetë (ditë) të plota. Kjo është për atë, familja e të cilit nuk banon pranë Xhamisë së shenjtë. Kini druajtje ndaj Allahut dhe dijeni që Allahu është i rreptë në ndëshkim.

198. Haxhi bëhet në muaj të caktuar. Kush vendos të bëjë haxhin në ta,

وَأَنْفِقُوا فِي سَبِيلِ اللَّهِ وَلَا تُلْقُوا بِأَيْدِيكُمْ  
إِلَى التَّهْلُكَةِ ۗ وَأَحْسِنُوا ۗ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ  
الْمُحْسِنِينَ ﴿١٩٦﴾

وَأَتِمُّوا الْحَجَّ وَالْعُمْرَةَ لِلَّهِ ۖ فَإِنْ  
أُحْصِرْتُمْ فَمَا اسْتَيْسَرَ مِنَ الْهَدْيِ ۚ وَلَا  
تَحْلِقُوا رُءُوسَكُمْ حَتَّىٰ يَبْلُغَ الْهَدْيُ  
مَحَلَّهُ ۖ فَمَنْ كَانَ مِنْكُمْ مَرِيضًا أَوْ بِهِ  
أَذًى مِنْ رَأْسِهِ فَفِدْيَةٌ مِنْ صِيَاءٍ أَوْ  
صَدَقَةٍ أَوْ نُسْكَ ۚ فَإِذَا أَمِنتُمْ ۖ فَمَنْ  
تَمَسَّ بِالْعُمْرَةِ إِلَى الْحَجِّ فَمَا اسْتَيْسَرَ مِنَ  
الْهَدْيِ ۚ فَمَنْ لَمْ يَجِدْ فِصْيَامَ ثَلَاثَةِ أَيَّامٍ فِي  
الْحَجِّ وَسَبْعَةٍ إِذَا رَجَعْتُمْ ۖ تِلْكَ عَشْرَةٌ  
كَامِلَةٌ ۚ ذَلِكَ لِمَنْ لَمْ يَكُنْ أَهْلَهُ  
حَاضِرِي الْمَسْجِدِ الْحَرَامِ ۖ وَاتَّقُوا اللَّهَ  
وَاعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ شَدِيدُ الْعِقَابِ ﴿١٩٧﴾

الْحَجَّ أَشْهُرٌ مَعْلُومَةٌ ۚ فَمَنْ قَرَضَ فِيهِنَّ  
الْحَجَّ فَلَا رَفَثَ وَلَا فُسُوقَ وَلَا جِدَالَ

Lufta gjatë këtyre muajve është e ndaluar me ligj. Urdhri erdhi për të siguruar shenjtërinë e Qabesë dhe të muajve të shenjtë. Megjithatë, u lejohet muslimanëve të luftojnë gjatë këtyre muajve, vetëm nëse kundërshtarët ose jomuslimanët nuk e respektojnë këtë rregull. Shih 9:5.

84. Umreja është një pelegrinazh më i vogël se haxhi. Umreja është vizita e Qabesë me *ihram* që përfshin shtatë herë *tavaf* rreth saj, ecje mes kodrinave Safa dhe Merva, etj.. Umreja bëhet në çdo kohë gjatë vitit, kurse haxhi bëhet vetëm gjatë muajit Dhul Hixhe. Lexoni edhe 3:98.

85. Nga ky ajet fillon tema e haxhit. Xhiahadi dhe haxhi duken se kanë lidhje me njëra-tjetrën sepse të dyja nxisin sakrificën, të cilën besimtari i vërtetë e bën në rrugë të Allahut, temë e cila vërehet se ka filluar nga ajeti 2:178. Pelegrinazhi i haxhit është shkalla e fundit e zhvillimit shpirtëror të besimtarit. Shkallët e tjera siç janë namazi, agjërimi, xhiahadi, pra, përpjekja në rrugën e Zotit, janë trajtuar në këtë sure përpara se të vinte tema e haxhit. Lexoni edhe 3:98.

nuk duhet t'i afrohet epshit, ligësisë dhe grindjes gjatë haxhit. Çdo mirësi që të bëni, do ta dijë Allahu. Pajisuni me ushqim për rrugë. Pa dyshim, ushqimi më i mirë është druajtja. Kini druajtje ndaj Meje, o të mençur!

199. Nuk është gjynah për ju që t'i kërkonit bekim Zotit tuaj. Kur të ktheheni nga Arafati, kujtojeni Allahun pranë Vendit të shenjtë. Kujtojeni Atë ashtu siç Ai ju ka udhëzuar, ndonëse më përpara keni qenë të humbur.

200. Pastaj, (edhe) ju kthehuni prej atje, siç kthehen njerëzit (e tjerë) dhe kërkojini falje Allahut. Allahu, pa dyshim, është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

201. Pra, kur përfundoni ritet (e haxhit) tuaj, kujtojeni Allahun, ashtu siç i kujtoni etërit tuaj, madje edhe më shumë. Prej njerëzve ka edhe të atillë që thonë: "O Zoti ynë! Na jep që në këtë botë (atë që ke për të dhënë)!" Ata nuk do të kenë asnjë pjesë në *ahiret*.

202. Dhe prej tyre ka edhe ata që thonë: "O Zoti ynë! Na jep të mirën në këtë botë, të mirën në *ahiret* dhe na shpëto nga ndëshkimi i zjarrit!"<sup>86</sup>

فِي الْحَجِّ<sup>ط</sup> وَمَا تَفَعَّلُوا مِنْ خَيْرٍ يَعْلَمُهُ  
اللَّهُ<sup>ت</sup> وَتَزَوَّدُوا فَإِنَّ خَيْرَ الزَّادِ التَّقْوَى<sup>و</sup>  
وَاتَّقُوا يَا أُولِي الْأَبَابِ<sup>١٩٩</sup>

لَيْسَ عَلَيْكُمْ جُنَاحٌ أَنْ تَبْتَغُوا فَضْلًا  
مِنْ رَبِّكُمْ<sup>ط</sup> فَإِذَا أَقَضْتُمْ مِنْ عَرَفَاتٍ  
فَاذْكُرُوا اللَّهَ عِنْدَ الْمَشْعَرِ الْحَرَامِ<sup>و</sup>  
وَاذْكُرُوهُ كَمَا هَدَيْتُمْ<sup>ع</sup> وَإِنْ كُنْتُمْ مِنْ  
قَبْلِهِ لَمَنِ الضَّالِّينَ<sup>٢٠٠</sup>

ثُمَّ أَيْقُضُوا مِنْ حَيْثُ أَقَاضَ النَّاسُ  
وَاسْتَغْفِرُوا اللَّهَ<sup>ط</sup> إِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَحِيمٌ<sup>٢٠١</sup>

فَإِذَا قَضَيْتُمْ مَنَاسِكَكُمْ فَاذْكُرُوا اللَّهَ  
كَذِكْرِكُمْ آبَاءَكُمْ أَوْ أَشَدَّ ذِكْرًا<sup>و</sup> فَمَنْ  
النَّاسِ مَنْ يَقُولُ رَبَّنَا آتِنَا فِي الدُّنْيَا  
وَمَا لَهُ فِي الْآخِرَةِ مِنْ خَلْقٍ<sup>٢٠٢</sup>

وَمِنْهُمْ مَنْ يَقُولُ رَبَّنَا آتِنَا فِي الدُّنْيَا  
حَسَنَةً<sup>و</sup> وَفِي الْآخِرَةِ حَسَنَةً<sup>و</sup> وَقِنَا عَذَابَ  
النَّارِ<sup>٢٠٣</sup>

86. Ndëshkimi i zjarrit në këtë ajet nuk nënkupton vetëm zjarrin e xhehenemit që do të jetë në *ahiret*, por shumë zjarre edhe të kësaj bote. Çdo njeri që jeton gjatë në këtë botë përballet me lloj-lloj zjarresh. Ndëshkime nga më të ndryshmet, frikë nga shumë gjëra, sëmundje, dështime, poshtërime, brenga gjithë farësh që vijnë nga familja, të afërmit etj., të gjitha këto nuk janë më pak se zjarri. Besimtari duhet t'i lutet Zotit që Ai ta shpëtojë nga të gjitha këto

203. Për të tillët do ketë shpërblim për atë që kanë punuar. Allahu është i shpejtë në llogari.

أُولَئِكَ لَهُمْ نَصِيبٌ مِّمَّا كَسَبُوا ۗ وَاللَّهُ  
سَرِيعُ الْحِسَابِ ﴿٢٠٣﴾

204. Kujtojeni (shumë) Allahun në (këto) pak ditë të numëruara. Ai që shpejton për të përfunduar në dy ditë, nuk bën gjynah dhe, edhe ai që qëndron, nuk bën gjynah, (kjo vlen) për atë që ka drujtje. Kini drujtje ndaj Allahut dhe dijeni që tek Ai do të mblidheni.<sup>87</sup>

وَاذْكُرُوا اللَّهَ فِي أَيَّامٍ مَّعْدُودَاتٍ ۗ فَمَنْ تَعَجَّلَ فِي يَوْمَيْنِ فَلَا إِثْمَ عَلَيْهِ ۗ وَمَنْ تَأَخَّرَ فَلَا إِثْمَ عَلَيْهِ ۗ لِمَنِ اثْتَمَلُ ۗ وَاتَّقُوا اللَّهَ ۗ وَعَلِمُوا أَنَّكُمْ إِلَيْهِ تُحْشَرُونَ ﴿٢٠٤﴾

205. Mes njerëzve është edhe ai që të kënaq me fjalën e tij rreth jetës së kësaj bote dhe sjell (edhe) Allahun si dëshmitar për atë që ka në zemrën e vet, por në të vërtetë, është grindaveci më i keq.

وَمِنَ النَّاسِ مَنْ يُعْجِبُ قَوْلَهُ فِي الْحَيَاةِ  
الدُّنْيَا وَيُشْهَدُ اللَّهَ عَلَىٰ مَا فِي قَلْبِهِ ۗ وَهُوَ  
أَلَدُّ الْخِصَامِ ﴿٢٠٥﴾

206. E kur zotëron fuqi, ai vrapon në tokë për të bërë çrregullime e për të shkatërruar të mbjellën dhe brezninë. Allahu nuk do çrregullim.

وَإِذَا تَوَلَّىٰ سَعَىٰ فِي الْأَرْضِ لِيُفْسِدَ فِيهَا  
وَيُهْلِكَ الْحَرْثَ وَالنَّسْلَ ۗ وَاللَّهُ لَا يُحِبُّ  
الْفُسَادَ ﴿٢٠٦﴾

207. Dhe kur i thuhet: “Ki drujtje ndaj Allahut!”, krenaria e mban të lidhur me mëkatin. I mjafton xhehenemi. Eh, sa vendbanim i keq është ai!

وَإِذَا قِيلَ لَهُ اتَّقِ اللَّهَ أَخَذَتْهُ الْعِزَّةُ  
بِالْإِثْمِ فَحَسْبُ جَهَنَّمُ ۗ وَلَيْسَ الْمَهَادُ ﴿٢٠٧﴾

208. Mes njerëzve është edhe ai që shet jetën e tij duke kërkuar pëlqimet e Allahut. Allahu është i Dhembshur ndaj robërve.

وَمِنَ النَّاسِ مَنْ يَشْرِي نَفْسَهُ ابْتِغَاءَ  
مَرْضَاتِ اللَّهِ ۗ وَاللَّهُ رَمُوفٌ بِالْعِبَادِ ﴿٢٠٨﴾

zjarre, dhe t'i drejtohet Atij – Unë që kam kapur pragon Tënd, o Zoti im, ma lehtëso jetën dhe më shpëto nga zjarri i saj. Lexoni edhe 69:33.

87. Objektivi themelor i haxhit është të arrish drujtjen ndaj Zotit (*takvanë*), siç pohohet në këtë ajet, po kështu edhe në ajetin 2:198, ku Kurani na sjell për herë të parë urdhrin e Haxhit. Po kjo *takva* është qëllimi i agjërimit (2:184), qëllimi i adhurimit ndaj Zotit (2:22) dhe gjithashtu edhe objektivi i Kuranit të Shenjtë (2:3). E gjithë kjo tregon se vetëm ritualet fizike pa ndonjë kuptim nuk mjaftojnë, madje ato duhen shoqëruar me doemos me drujtjen ndaj Zotit dhe kjo pikërisht duhet të jetë edhe esenca e të gjitha veprave të besimtarit.

209. O ju që besuat! Ju që të gjithë hyni në (rrethin) e bindjes dhe mos ndiqni gjurmët e djallit! Pa dyshim, ai është armik i hapët për ju.

210. Po rrëshqitët, edhe pse ju kanë ardhur shenjat e qarta, atëherë dijeni se Allahu është i Plotfuqishëm, i Urtë.

211. A po presin ata vetëm që Allahu t'u vijë nën hijen e reve, po ashtu edhe engjëjt, dhe çështja të vendoset?! Tek Allahu do të kthehen të gjitha çështjet.

212. Pyeti bijtë e Izraelit se sa shumë shenja të qarta u kishim dhënë atyre. Kushdo që ndërron bekimin e Allahut, pasi i ka ardhur ai, (le ta dijë se) Allahu është i rreptë në ndëshkim.<sup>88</sup>

213. Jeta e kësaj bote u është paraqitur joshëse atyre që mohuan, të cilët tallen me besimtarët. Këta që kanë drujtje, Ditën e Kiametit, do të kenë epërsi mbi ta. Allahu i jep pa masë atij që do.

214. Njerëzit ishin një popull i vetëm. Allahu ngriti Profetët si sihariqdhënës dhe alarmues dhe me ta zbriti edhe Librin me të vërtetën për të gjykuar njerëzit në çështjet, në të cilat ata kundërshtonin njëri-tjetrin. Dhe rreth këtij (Libri) ranë në kundërshti vetëm ata, të cilëve u

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا ادْخُلُوا فِي السِّلْمِ كَآفَّةً  
وَلَا تَتَّبِعُوا خُطُوَاتِ الشَّيْطَانِ إِنَّهُ لَكُمْ عَدُوٌّ  
مُبِينٌ ﴿٢٠٩﴾

فَإِنْ زَلَلْتُمْ مِنْ بَعْدِ مَا جَاءَتْكُمْ الْبَيِّنَاتُ  
فَاعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ عَزِيزٌ حَكِيمٌ ﴿٢١٠﴾

هَلْ يَنْظُرُونَ إِلَّا أَنْ يَأْتِيَهُمُ اللَّهُ فِي ظُلَلٍ  
مِنَ الْعَمَامِ وَالْمَلِكَةِ وَقُضِيَ الْأَمْرُ وَإِلَى  
اللَّهِ تُرْجَعُ الْأُمُورُ ﴿٢١١﴾

سَلَّ بَنِي إِسْرَائِيلَ كَمَا آتَيْتَهُمْ مِنْ آيَةٍ  
بَيِّنَةٍ وَمَنْ يُبَدِّلْ نِعْمَةَ اللَّهِ مِنْ بَعْدِ مَا  
جَاءَتْهُ فَإِنَّ اللَّهَ شَدِيدُ الْعِقَابِ ﴿٢١٢﴾

رَبِّنَ لِلَّذِينَ كَفَرُوا الْحَيَاةَ الدُّنْيَا  
وَيَسْخَرُونَ مِنَ الَّذِينَ آمَنُوا وَالَّذِينَ  
اتَّقَوْا فَوْقَهُمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ وَاللَّهُ يَرْزُقُ  
مَنْ يَشَاءُ بِغَيْرِ حِسَابٍ ﴿٢١٣﴾

كَانَ النَّاسُ أُمَّةً وَاحِدَةً فَبَعَثَ اللَّهُ  
النَّبِيِّنَ مُبَشِّرِينَ وَمُنذِرِينَ وَأَنْزَلَ  
مَعَهُمُ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ لِيَحْكُمَ بَيْنَ النَّاسِ  
فِيمَا اخْتَلَفُوا فِيهِ وَمَا اخْتَلَفَ فِيهِ إِلَّا  
الَّذِينَ أُوتُوهُ مِنْ بَعْدِ مَا جَاءَتْهُمْ الْبَيِّنَاتُ

88. Nuk do të thotë se gjoja Zoti është i vrazhdë dhe i pamëshirshëm, por do të thotë se kur ndëshkimi i Tij i vjen njeriut, ai do ta kalojë rëndë atë.

ishte dhënë ai dhe u kishin ardhur edhe shenjat e qarta, por që kishin armiçësi ndaj njëri-tjetrit. Allahu me urdhrin e Vet i përdhri ata që besuan, për shkak se kundërshtitë e tyre rreth tij bazoheshin në të vërtetën. Dhe Allahu përdhri kë të dojë në rrugën e drejtë.<sup>89</sup>

215. A kujtoni se do të hyni në xhenet, edhe pse ende nuk keni provuar atë që kanë provuar ata që ishin para jush? Ata u goditën nga vuajtjet e vështirësitë, dhe u tronditën aq shumë, sa që i Dërguari dhe ata që besuan bashkë me të, thirrën: “Kur do të vijë ndihma e Allahut?!” Dëgjoni! Ndhima e Allahut, pa dyshim është afër.<sup>90</sup>

216. Ata të pyesin ty se çfarë duhet të shpenzojnë. Thuaj: Gjithçka që doni të shpenzoni nga pasuria (juaj), shpenzoheni për prindërit, për të afërmit, për jetimët, për të varfrit dhe për mysafirët. Çdo mirësi që do të bëni, Allahu është i Gjithëdijshëm për të.

217. Juve ju është obliguar lufta, ndërkohë ajo nuk ju pëlqente. Ka

بَعِيًا بَيْنَهُمْ ۚ فَهَدَى اللَّهُ الَّذِينَ آمَنُوا لِمَا  
اِخْتَلَفُوا فِيهِ مِنَ الْحَقِّ بِإِذْنِهِ ۗ وَاللَّهُ  
يَهْدِي مَنْ يَشَاءُ إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ ﴿١٩﴾

أَمْ حَسِبْتُمْ أَنْ تُدْخَلُوا الْجَنَّةَ وَلَمَّا يَأْتِكُمْ  
مَثَلُ الَّذِينَ خَلَوْا مِنْ قَبْلِكُمْ ۗ مَسَّتْهُمُ  
الْبَاسَاءُ وَالضَّرَّاءُ وَزُلْزِلُوا حَتَّى يَقُولَ  
الرَّسُولُ وَالَّذِينَ آمَنُوا مَعَهُ مَتَى نَصْرُ  
اللَّهِ ۗ أَلَا إِنَّ نَصْرَ اللَّهِ قَرِيبٌ ﴿٢٠﴾

يَسْأَلُونَكَ مَاذَا يُنْفِقُونَ ۗ قُلْ مَا أَنْفَقْتُمْ مِنْ  
خَيْرٍ فَلِلَّوَالِدَيْنِ وَالْأَقْرَبِينَ وَالْيَتَامَى  
وَالْمَسْكِينِ وَابْنِ السَّبِيلِ ۗ وَمَا تَفْعَلُوا مِنْ  
خَيْرٍ فَإِنَّ اللَّهَ بِهِ عَلِيمٌ ﴿٢١﴾

كُتِبَ عَلَيْكُمُ الْقِتَالُ وَهُوَ كُرْهُ لَكُمْ ۚ  
وَاعْسَى أَنْ تُكْرَهُوا شَيْئًا وَهُوَ خَيْرٌ

89. Para se të vijë ndonjë profet, gjithë njerëzit janë në një gjendje. Edhe ata që besojnë në Profetët e mëparshëm, në përgjithësi, nuk dallojnë nga të tjerët në ligësi e padëgjueshmëri. Pra, kjo është një dukuri e përgjithshme që para se të vijë ndonjë profet, të gjithë njerëzit jetojnë në një gjendje, edhe pse me emër mund të jenë besimtarë a jobesimtarë. Nëpërmjet Profetit kur u vjen Libri dhe u vijnë urdhëresat dhe ndalesat në mënyrë të qartë, atëherë kundërshtimi ndaj Profetit i ndan në dy grupe: njëri që e beson Profetin dhe tjetri që e mohon atë.

90. Pranimi i Islamit nuk ishte një kopsht me lule për muslimanët, përkundrazi, që në fillim Zoti i paralajmëroi se do t'u duhej të kalonin nëpër sprova të rënda dhe vështirësi sflitëse, përpara se të arrinin idealin e tyre sublim.

mundësi që të mos pëlqeni diçka, kurse ajo të jetë e mirë për ju dhe ka mundësi që të pëlqeni diçka, kurse ajo të jetë e keqe për ju. Allahu di dhe ju nuk dini.

218. Të pyesinty për muajin e shenjtë, pra, për luftën gjatë tij. Thuaju: “Lufta në të është (mëkat) i madh. Dhe pengimi nga rruga e Allahut, mohimi i Tij, pengimi nga Xhamia e shenjtë dhe dëbimi i banorëve të saj nga ajo është (mëkat) akoma më i madh tek Allahu. Persekutimi është më i keq se vrasja”. Ata nuk do të pushojnë së luftuari me ju, derisa t’ju kthejnë nga besimi juaj, nëse munden. Prej jush, ata që kthehen nga besimi i tyre dhe vdesin në gjendje kur janë mohues, do të humbasin veprat e tyre edhe në këtë botë, edhe në *ahiret*. Të tillët janë banorë të zjarrit dhe në të do të jetojnë për një kohë të gjatë.

219. Me të vërtetë, ata që besuan, ata që mërguan dhe u përpoqën në rrugën e Allahut, shpresojnë mëshirën e Allahut. Dhe Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

220. Të pyesin ty për alkoolin dhe kumarin. Thuaj: “Nga to ka (edhe) mëkat të madh, edhe dobi për njerëzit. Por mëkati prej tyre është më i madh sesa dobia e tyre”.<sup>91</sup> Dhe

لَكُمْ<sup>٢</sup> وَعَسَىٰ أَنْ تُحِبُّوا شَيْئًا وَهُوَ  
شَرٌّ لَّكُمْ<sup>١٦</sup> وَاللَّهُ يَعْلَمُ وَأَنْتُمْ لَا تَعْلَمُونَ<sup>١٧</sup>

يَسْأَلُونَكَ عَنِ الشَّهْرِ الْحَرَامِ قِتَالٍ فِيهِ<sup>١٨</sup>  
قُلْ قِتَالٌ فِيهِ كَبِيرٌ<sup>١٩</sup> وَصَدٌّ عَنْ سَبِيلِ اللَّهِ  
وَكُفْرٌ بِهِ وَالْمَسْجِدِ الْحَرَامِ<sup>٢٠</sup> وَ إِخْرَاجُ  
أَهْلِهِ مِنْهُ أَكْبَرُ عِنْدَ اللَّهِ<sup>٢١</sup> وَالْفِتْنَةُ  
أَكْبَرُ مِنَ الْقَتْلِ<sup>٢٢</sup> وَلَا يَرَاؤُنَ يِقَاتِلُوكُمْ  
حَتَّىٰ يَرُدُّوكُمْ عَنْ دِينِكُمْ<sup>٢٣</sup> إِنِ اسْتَطَاعُوا<sup>٢٤</sup>  
وَمَنْ يَّرْتَدِدْ مِنْكُمْ عَنْ دِينِهِ<sup>٢٥</sup> فِيمَتَّ  
وَهُوَ كَافِرٌ فَأُولَٰئِكَ حَبِطَتْ أَعْمَالُهُمْ فِي  
الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ<sup>٢٦</sup> وَأُولَٰئِكَ أَصْحَابُ النَّارِ<sup>٢٧</sup>  
هُمْ فِيهَا خَالِدُونَ<sup>٢٨</sup>

إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَالَّذِينَ هَاجَرُوا  
وَجَاهَدُوا فِي سَبِيلِ اللَّهِ<sup>٢٩</sup> أُولَٰئِكَ يَرْجُونَ  
رَحْمَتَ اللَّهِ<sup>٣٠</sup> وَاللَّهُ غَفُورٌ رَّحِيمٌ<sup>٣١</sup>

يَسْأَلُونَكَ عَنِ الْخَمْرِ وَالْمَيْسِرِ<sup>٣٢</sup> قُلْ فِيهِمَا  
إِثْمٌ كَبِيرٌ<sup>٣٣</sup> وَمَنَافِعُ لِلنَّاسِ<sup>٣٤</sup> وَإِثْمُهُمَا  
أَكْبَرُ مِنْ نَّفْعِهِمَا<sup>٣٥</sup> وَيَسْأَلُونَكَ مَاذَا

91. Ky ajet paraqet një parim të përgjithshëm të gjërave të lejuara e të ndaluara. Ato gjëra që janë më shumë të dobishme dhe më pak të dëmshme, janë të lejuara, ndërsa ato që edhe pse kanë pak dobi, por dëmet e tyre janë të shumta, cilësohen si të ndaluara. Konsumi i alkoolit është i dëmshëm, prandaj, konsumi i tij edhe në sasi të vogël, është i ndaluar. Por alkooli ka rëndësi të veçantë në mjekësi. Po ashtu ai përdoret edhe në parfum. Dikush edhe sikur t'i

të pyesin ty se çfarë të shpenzojnë. Thuaj: “Atë që ju tepron”. Kështu Allahu ju shpjegon qartë shenjat e Tij, që të mendoni;

يُنْفِقُونَ قُلِ الْعَفْوَ كَذَلِكَ يُبَيِّنُ اللَّهُ لَكُمْ الْآيَاتِ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ ﴿١٧﴾

221. për këtë botë dhe për tjetrën; dhe ata të pyesin ty për jetimët. Thuaj: “Mirërritja e tyre është vepër e mirë. Nëse jetoni bashkë me ta, ata janë vëllezërit tuaj. Dhe Allahu di të dallojë keqbërësin nga mirëbërësi. Po të donte Allahu, do t’ju fuste në vështirësi. Allahu, pa dyshim është i Plotfuqishëm, i Urtë.

فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ وَيَسْأَلُونَكَ عَنِ الْيَتَامَىٰ قُلْ إِصْلَاحٌ لَّهُمْ خَيْرٌ وَإِنْ تُخَالِطُوهُمْ فَإِحْوَانُكُمْ وَاللَّهُ يَعْلَمُ الْمُفْسِدَ مِنَ الْمُصْلِحِ وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ لَأَعْتَبْتُمْ إِنْ اللَّهَ عَزِيزٌ حَكِيمٌ ﴿١٨﴾

222. Mos u martoni me idhujtaret, derisa ato të besojnë. Sigurisht, një skllave besimtare është më e mirë sesa një idhujtare (e lirë), sado që ju pëlqen ajo. Dhe mos i martoni (vajzat tuaja) me idhujtarët, derisa ata të besojnë. Sigurisht, një skllav besimtar është më i mirë sesa një idhujtar (i lirë), sado që ju pëlqen ai. Ata (ju) thërrasin drejt zjarrit, kurse Allahu, me urdhrin e Tij, (ju) thërret drejt xhenetit dhe faljes. Ai ua shpjegon qartazi njerëzve shenjat e Tij, që ata të ndërgjegjësohen.<sup>92</sup>

وَلَا تَنْكِحُوا الْمُشْرِكَةَ حَتَّىٰ يُوْمِنَ ۖ وَلَا أُمَمَةٌ مُّؤْمِنَةٌ خَيْرٌ مِّنْ مُّشْرِكَةٍ وَلَا تُؤْمِنُوا أَعْرَبِيكُمْ ۖ وَلَا تُنكِحُوا الْمُشْرِكِينَ حَتَّىٰ يُوْمِنُوا ۗ وَلَعَبْدٌ مُّؤْمِنٌ خَيْرٌ مِّنْ مُّشْرِكٍ ۖ وَلَا تَتَّبِعُوا أَهْلَ الْبَيْتِ ۚ وَاللَّهُ يَدْعُو إِلَى الْبَيْتِ وَالْمَغْفِرَةَ بِآدَابِهِ ۚ وَيُبَيِّنُ آيَاتِهِ لِلنَّاسِ لَعَلَّهُمْ يَتَذَكَّرُونَ ﴿١٩﴾

223. Dhe të pyesin për gjendjen e menstruacioneve. Thuaj: Ajo është (gjendje) e dhimbshme, prandaj, rrini larg grave kur ato janë me menstruacionet. Mos bëni

وَيَسْأَلُونَكَ عَنِ الْمَحِيضِ قُلْ هُوَ أَدَىٰ ۖ فَأَعْتَزِلُوا النَّسَاءَ فِي الْمَحِيضِ وَلَا تَقْرَبُوهُنَّ حَتَّىٰ يَطْهَرْنَ ۚ فَإِذَا تَطَهَّرْنَ

hedhë vetes parfum të tillë në sasi të madhe, kurrë nuk dehet.

92. Profeti Muhammed<sup>savs</sup> tha: Një burrë martohet me një grua duke vlerësuar katër gjëra: pasurinë e saj, statusin familjar të saj, bukurinë e saj dhe fenë e saj. Ti duhet t’i japësh përparësi fesë së saj, përndryshe do të jesh në humbje. (Buhari, nr. 5090)

marrëdhëniet me to, derisa ato të pastrohen. Kur të pastrohen, afrojuni atyre në atë mënyrë siç ju ka urdhëruar Allahu. Allahu me të vërtetë i do të penduarit dhe i do të pastrit.

224. Gratë tuaja janë ara për ju. Pra, afrojuni arave tuaja si të doni.<sup>93</sup> Dërgoni përpara diçka për veten tuaj, kini druajtje ndaj Allahut dhe dijeni se keni për ta takuar Atë. Jezu (këtë) lajm të gëzueshëm besimtarëve.

225. Mos e bëni Allahun në premtimet tuaja pengesë për të bërë mirësi, për të arritur druajtjen dhe për të bërë pajtim mes njerëzve. Me të vërtetë, Allahu është Gjithëdhëgjues, i Gjithëdijshëm.

226. Allahu nuk do t'ju kapë për premtimet tuaja të kota, por do t'ju kapë për ato premtime, me të cilat zemrat tuaja fitojnë (mëkat). Allahu është shumë Falës, shumë i Përmbajtur.

227. Ata që betohen për të mos shkuar me gratë e tyre, mund të presin deri në katër muaj. Nëse kthehen, Allahu patjetër është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.<sup>94</sup>

فَأْتُوهُنَّ مِنْ حَيْثُ أَمَرَكُمُ اللَّهُ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ التَّوَّابِينَ وَيُحِبُّ الْمُطَهَّرِينَ ﴿٣٧﴾

نِسَاءُكُمْ حَرِّثَ لَكُمْ فَأْتُوا حَرْثَكُمْ أَنْتُمْ شِئْتُمْ وَقَدِّمُوا لِأَنْفُسِكُمْ وَاتَّقُوا اللَّهَ وَعَلِمُوا أَنَّكُمْ مُلْقَوَةٌ وَبَشِّرِ الْمُؤْمِنِينَ ﴿٣٨﴾

وَلَا تَجْعَلُوا اللَّهَ عُرْضَةً لِإِيمَانِكُمْ أَنْ تَبَرُّوا وَتَتَّقُوا وَتُصْلِحُوا بَيْنَ النَّاسِ وَاللَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ ﴿٣٩﴾

لَا يُؤَاخِذُكُمُ اللَّهُ بِاللَّغْوِ فِي أَيْمَانِكُمْ وَلَكِنْ يُؤَاخِذُكُمْ بِمَا كَسَبَتْ قُلُوبُكُمْ وَاللَّهُ غَفُورٌ حَلِيمٌ ﴿٤٠﴾

لِلَّذِينَ يُؤْلُونَ مِنْ نِسَائِهِمْ تَرَبُّصُ أَرْبَعَةِ أَشْهُرٍ فَإِنْ فَاءُوا فَإِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَحِيمٌ ﴿٤١﴾

93. Këtë ajet, disa të padrejtë e mizorë e shtrembërojnë dhe, *ma'adhallah*, nxjerrin përfundimin se ajeti i lejuaka të bëjnë marrëdhënie të panatyrshme me bashkëshortet. Kjo është një mizori e madhe ndaj këtij ajeti, i cili shprehet shumë qartë se gratë janë faktor kyç i vazhdimësisë së jetës njerëzore dhe me marrëdhënie të panatyrshme ato assesi nuk mund të luajnë rolin e tyre.

94. Ajetet 225-227: Arabët kishin zakonet që disa njerëz betoheshin në Zot për të mos pasur marrëdhënie me gratë e veta, duke mos u dhënë divorcin. Në këtë mënyrë, ata e kujtonin veten të lirë nga përgjegjësitë me të cilat jeta bashkëshortore i ngarkonte ata, sepse justifikonin se



228. E nëse do të marrin vendimin e divorcit, atëherë Allahu me të vërtetë është Gjithëdëgjues, i Gjithëdijshëm.<sup>95</sup>

وَإِنْ عَزَمُوا الطَّلَاقَ فَإِنَّ اللَّهَ سَمِيعٌ عَلِيمٌ ﴿١٣٧﴾

229. Gratë e divorcuara duhet të presin deri në tri të përmuajshme. Nuk u lejohet të fshehin atë që Allahu u ka krijuar në mitrat e tyre, po qe se ato besojnë në Allah dhe në Ditën e Fundit. Në këso rastesh, bashkëshortët e tyre kanë më shumë të drejtë për t'i rimarrë ato, po qe se duan të pajtohen. Si rregull, ato kanë po aq të drejta (mbi burrat) sa kanë detyrime (ndaj tyre), ndonëse, meshkujt kanë një epërsi mbi to.<sup>96</sup> Allahu është i Plotfuqishëm, i Urtë.<sup>97</sup>

وَالْمُطَلَّاتُ يَتَرَبَّصْنَ بِأَنْفُسِهِنَّ ثَلَاثَةَ قُرُوءٍ ۗ وَلَا يَحِلُّ لَهُنَّ أَنْ يَكْمُنَ مَا خَلَقَ اللَّهُ فِي أَرْحَامِهِنَّ إِنْ كُنَّ يُؤْمِنُنَّ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ ۗ وَبِعُولَتِهِنَّ أَعْيُ يَرُدُّهِنَّ فِي ذَلِكَ إِنْ أَرَادُوا إِصْلَاحًا وَلَهُنَّ مِثْلُ الَّذِي عَلَيْهِنَّ بِالْمَعْرُوفِ ۗ وَاللِّرِّجَالِ عَلَيْهِنَّ دَرَجَةٌ ۗ وَاللَّهُ عَزِيزٌ حَكِيمٌ ﴿١٣٨﴾

detyrimi i tyre ndaj Zotit për shkak të betimit që bënë, ishte më i rëndësishëm sesa detyrimi ndaj grave të tyre. Të tillëve Allahu u thotë – kanë afat vetëm deri në katër muaj, sepse më pas gratë e tyre nuk mund të mbahen pezull, dhe ata ose duhet të pajtohen me to, ose duhet t'i divorcojnë. Menjëherë pas këtij ajeti, trajtohet tema e divorcit. Edhe sot në botë ka shumë që e quajnë veten besimtarë, por që marrin diçka Hyjnore si mburojë për të mos i shlyer detyrimet e tyre ndaj njerëzve.

95. Nëse burri vendos ta divorcojë gruan e tij, *duhet ta dijë që Allahu është Gjithëdëgjues, i Gjithëdijshëm*. Kjo do të thotë se në dijeninë e Allahut nëse gruas së divorcuar i është bërë padrejtësi në këtë divorc dhe nëse ajo i lutet Allahut kundër ish-burrit të saj, Allahu do t'ia dëgjojë lutjen.

96. Për sa u përket të drejtave, sipas Islamit, ato janë të barabarta mes burrit dhe gruas, por siç është vënë në pah në 4:35, burrat kanë një përgjegjësi kujdestarie për shkak të forcës fizike që ata kanë dhe për shkak të përgjegjësisë financiare me të cilën ata janë të obliguar ndaj familjes. Lexoni edhe 4:35.

97. *“Si rregull, gratë kanë po aq të drejta (mbi burrat) sa kanë detyrime (ndaj tyre)”*. Me këtë deklaratë Islami pohon se burrat dhe gratë kanë të drejta të barabarta. Sjellja e burrit ndaj gruas duhet jetë e sinqertë porsì dy shokë. Dëshmitarja e parë e virtyeteve të burrit dhe e lidhjes së tij me Zotin është pikërisht gruaja e tij. Andaj, nëse burri nuk ka marrëdhënie pozitive me gruan e tij, si mund të rregullojë marrëdhënien e tij me Zotin?! Prandaj i Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> tha: *“Më i miri prej jush është ai që është më i miri ndaj gruas së tij.”* (Buhari, nr. 1977)

230. Divorci bëhet dy herë. E (më pas gruaja) ose mbahet në mënyrë të drejtë ose përcillet me të mirë. Nuk ju lejohet që t'u merrni ndonjë gjë nga ato që ua keni dhënë atyre, veçse nëse të dy frikësohen se nuk do të mund t'i zbatojnë kufijtë e Allahut. Pra, nëse keni frikë se ata nuk do të mund t'i zbatojnë kufijtë e Allahut, nuk ka gjynah për ta, nëse ajo i lë diçka (burrit, për ta përfunduar çështjen gjyqësore).<sup>98</sup> Këta janë kufijtë e Allahut, prandaj, mos i shkelni. Ata që i shkelin kufijtë e Allahut, janë të padrejtë.

231. Nëse sërish ai i jep divorc asaj, ajo nuk ka të drejtë të martohet me të, pa u martuar me një burrë tjetër. E nëse (edhe) ai i jep divorc, ata nuk kanë gjynah që të pajtohen, nëse mendojnë se (këtë herë) do të arrijnë t'i zbatojnë kufijtë e Allahut. Pra, këta janë kufijtë e Allahut, të cilët Ai ua shpjegon qartazi atyre që dinë.<sup>99</sup>

الطَّلَاقُ مَرَّتَيْنِ ۖ فَمَا سَاكُ بِمَعْرُوفٍ أَوْ  
تَسْرِيحٍ بِإِحْسَانٍ ۗ وَلَا يَحِلُّ لَكُمُ أَنْ  
تَأْخُذُوا مِمَّا آتَيْتُمُوهُنَّ شَيْئًا إِلَّا أَنْ  
يَخَافَا أَلَّا يُقِيمَا حُدُودَ اللَّهِ ۗ فَإِنْ خِفْتُمَا  
أَلَّا يُقِيمَا حُدُودَ اللَّهِ ۗ فَلَا جُنَاحَ عَلَيْهِمَا  
فِيمَا افْتَدَتْ بِهِ ۗ تِلْكَ حُدُودُ اللَّهِ فَلَا  
تَعْدُوا هَا ۗ وَمَنْ يَتَعَدَّ حُدُودَ اللَّهِ فَأُولَٰئِكَ  
هُمُ الظَّالِمُونَ ﴿٢٣٠﴾

فَإِنْ طَلَّقَهَا فَلَا تَحِلُّ لَهُ مِنْ بَعْدِ حَتَّى  
تَتَّخِجَ زَوْجًا غَيْرَهُ ۗ فَإِنْ طَلَّقَهَا فَلَا جُنَاحَ  
عَلَيْهِمَا أَنْ يَتَرَاجَعَا إِنْ ظَنَّا أَنْ يُقِيمَا  
حُدُودَ اللَّهِ ۗ وَتِلْكَ حُدُودُ اللَّهِ يُبَيِّنُهَا  
لِقَوْمٍ يَعْلَمُونَ ﴿٢٣١﴾

98. Islami i dha burrit të drejtën për të divorcuar gruan e tij dhe ky divorc në terminologjinë islame quhet *talak*, po kështu edhe gruas i dha të drejtën që t'i drejtohet gjykatës për t'u ndarë nga burri, dhe ky divorc në terminologjinë islame quhet *khula*. Në fenë Islame, divorci është shumë i papëlqyeshëm. I Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> tha: “Nga të gjitha veprat e lejuara, më e urryera tek Allahu është divorci.” (Ebu Davud, nr. 2178)

99. Ajetet 230-231: Një pjesë e madhe e dijetarëve të sotëm besojnë se ai që i tha me gojë tri herë fjalën *divorc* (*talak*) gruas së tij, i ka konsumuar të tria mundësitë për t'i dhënë divorc dhe si i tillë, ai nuk mund të rimartohet me të, përpara se ajo të martohet me një burrë tjetër dhe të jetë ndarë prej tij. Por kjo nuk është e saktë. Kurani i Shenjtë qartazi pohon në këtë ajet “Divorci (*talak*) bëhet dy herë.” Domethënë divorci që nuk është i pakthyesëm (*talaku bain*), mund të bëhet dy herë. Domethënë, pas divorcit të parë, burri ose do ta kthejë divorcin duke u pajtuar me gruan brenda afatit, ose nëse mbaron afati, ta kthejë divorcin duke bërë *nikah* të ri. Pas kësaj nëse sërish nuk pajtohet, i jep divorc. Pra, divorci i tillë nëse bëhet të paktën dy herë, nuk lind fare mundësia për t'i dhënë divorc tri herë njëkohësisht. Divorci i pakthyesëm, pra i treti, është vetëm ai që tri herë kalon nga procesi i lartpërmendur. Pas kësaj, sipas Kuranit, ajo grua nuk është më e lejuar për të, derisa ajo të martohet me një

232. Kur t'u jepni divorc grave dhe ato të plotësojnë afatin e tyre të caktuar, daç mbajini njerëzisht, daç përcillini njerëzisht. Mos i mbani ato për t'i lënduar e për t'i shfrytëzuar. Ai që bën këtë, vetes i bën keq. Mos i merrni ajetet e Allahut për shaka dhe kujtojeni bekimin e Allahut që keni dhe atë që Ai ka zbritur mbi ju prej Librit dhe urtësisë; përmes tij, Ai ju këshillon. Kini druajtje ndaj Allahut dhe dini se Allahu është i Gjithëdijshëm për çdo gjë.

وَإِذَا طَلَّقْتُمُ النِّسَاءَ فَبَلَّغْنَ أَجَلَهُنَّ فَأَمْسِكُوهُنَّ بِمَعْرُوفٍ أَوْ سَرِّحُوهُنَّ بِمَعْرُوفٍ وَلَا تَمْسِكُوهُنَّ ضَرَارًا لِّتَعْتَدُوا وَمَنْ يَفْعَلْ ذَلِكَ فَقَدْ ظَلَمَ نَفْسَهُ وَلَا تَتَّخِذُوا آيَاتِ اللَّهِ هُزُوعًا وَادْكُرُوا نِعْمَتَ اللَّهِ عَلَيْكُمْ وَمَا أَنْزَلَ عَلَيْكُمْ مِنَ الْكِتَابِ وَالْحِكْمَةِ يَعِظُكُمْ بِهِ ۗ وَاتَّقُوا اللَّهَ وَاعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ ﴿٢٣٢﴾

233. Kur t'u jepni divorc grave dhe ato të plotësojnë afatin e tyre të caktuar, mos i pengoni të martohen me bashkëshortët e tyre (të ardhshëm), nëse ata bien dakord me mirëkuptim. Kështu këshillohet ai prej jush që beson në Allah dhe në Ditën e Fundit. Kjo është më e dëlirshme dhe më e pastër për ju. Dhe Allahu di, kurse ju nuk dini.

وَإِذَا طَلَّقْتُمُ النِّسَاءَ فَبَلَّغْنَ أَجَلَهُنَّ فَلَا تَعْضُلُوهُنَّ أَنْ يَنْكِحْنَ أَرْوَاجَهُنَّ إِذَا تَرَاضُوا بَيْنَهُم بِالْمَعْرُوفِ ۗ ذَلِكَ يُوعِظُ بِهِ مَنْ كَانَ مِنْكُمْ يُؤْمِنُ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ ۗ ذَلِكَمَ آزَكَىٰ لَكُمْ وَأَطْهَرُ ۗ وَاللَّهُ يَعْلَمُ وَأَنْتُمْ لَا تَعْلَمُونَ ﴿٢٣٣﴾

234. Nën timer t'u japin gji fëmijëve të tyre plot dy vjet; kjo është për atë që dëshiron të plotësojë gjidhënien. Si rregull, i ati (i fëmijës) ka për detyrë t'u sigurojë (grave) ushqim dhe veshmbathje. Askush nuk ngarkohet përtej mundësisë së tij. As nëna nuk duhet të dëmtohet për shkak të fëmijës së saj, as babai për

وَالْوَالِدَاتُ يُرْضِعْنَ أَوْلَادَهُنَّ حَوْلَيْنِ كَامِلَيْنِ لِمَنْ أَرَادَ أَنْ يُتِمَّ الرَّضَاعَةَ ۗ وَعَلَى الْمَوْلُودِ لَهُ رِزْقُهُنَّ وَكِسْوَتُهُنَّ بِالْمَعْرُوفِ ۗ لَا تُكَلِّفُ نَفْسٌ إِلَّا أَوْسَعَهَا ۗ لَا تَضَارَّ وَالِدَةٌ بِوَلَدِهَا وَلَا مَوْلُودٌ لَهُ بِوَالِدِهِ ۗ وَعَلَى الْوَارِثِ مِثْلُ ذَلِكَ ۗ فَإِنْ

burrë tjetër dhe pas mospajtimit mes tyre, të jetë ndarë prej tij. Ka nga ata që në mënyrë të poshtëruar bëjnë një zakon që e quajnë *halala*, pra martesë të përkohshme, për t'u rimartuar me gruan të cilën e kanë divorcuar tri herë. *Halala* nuk ka vend në fenë Islame.

shkak të fëmijës së tij.<sup>100</sup> E njëjta porosi vlen edhe për trashëgimtarin. Nëse të dy (prindërit) me pëlqimin dhe këshillimin e tyre, duan të ndërpresin gjdhënien, nuk ka gjynah për ta. Gjithashtu, nëse doni t'u gjeni mëndeshë fëmijëve tuaj, nuk ka gjynah për ju, me kusht që pasi t'i kenë siguruar atë që duhet t'ia jepni sipas rregullit. Kijeni druajtjen ndaj Allahut dhe dijeni se Allahu di mirë çdo gjë që bëni.

235. Ata që vdesin midis jush dhe lënë pas bashkëshorte, ato le të presin katër muaj e dhjetë ditë. E kur ta plotësojnë afatin e tyre, ju nuk hyni në gjynah nëse ato do të bëjnë diçka për veten e tyre në mënyrë të pranueshme. Allahu di mirë çdo gjë që bëni.

236. Po ashtu, nuk është gjynah për ju nëse jepni shenjë për t'u martuar me gratë e tilla ose ta mbani të fshehtë (këtë mendim) në zemrën tuaj. Allahu e di që ju patjetër do të mendoni për to. Por mos u premtoni fshehurazi, (por mund t'u) thoni veç fjalë të mira. Mos vendosni për martesë derisa atyre nuk u mbaron afati. Dijeni se Allahu e di çka keni në veten tuaj, andaj ruhuni prej Tij dhe dijeni se Allahu është shumë Mëkatfalës, shumë i Përmbajtur.

أَرَادَا فِصَالًا عَنْ تَرَاضٍ مِّنْهُمَا وَتَشَاوُرٍ  
فَلَا جُنَاحَ عَلَيْهِمَا ۗ وَإِن أَرَدْتُمْ أَن  
تَسْتَرْضِعُوا أَوْلَادَكُمْ فَلَا جُنَاحَ عَلَيْكُمْ  
إِذَا سَلَّمْتُمْ مَا ابْتِئْتُم بِالْمَعْرُوفِ ۗ وَاتَّقُوا  
اللَّهَ وَاعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ بِمَا تَعْمَلُونَ بَصِيرٌ ﴿٢٣٥﴾

وَالَّذِينَ يَتَّبِعُونَ مَوْتَهُمْ وَيَدْرُونَ أَرْوَاجًا  
يَتَرَبَّصْنَ بِأَنْفُسِهِنَّ أَرْبَعَةَ أَشْهُرٍ وَعَشْرًا ۗ  
فَإِذَا بَلَغْنَ أَجَلَهُنَّ فَلَا جُنَاحَ عَلَيْكُمْ فِيمَا  
فَعَلْنَ فِي أَنْفُسِهِنَّ بِالْمَعْرُوفِ ۗ وَاللَّهُ بِمَا  
تَعْمَلُونَ خَبِيرٌ ﴿٢٣٦﴾

وَلَا جُنَاحَ عَلَيْكُمْ فِيمَا عَرَّضْتُمْ بِهِ مِنْ  
خِطْبَةِ النِّسَاءِ أَوْ أَكْنَنْتُمْ فِي أَنْفُسِكُمْ ۗ  
عَلِمَ اللَّهُ أَنكُمْ سَتَذَكَّرُوهُنَّ وَلَكِن  
لَّا تُوَاعِدُوهُنَّ سِرًّا إِلَّا أَنْ تَقُولُوا قَوْلًا  
مَّعْرُوفًا ۗ وَلَا تَعْرِضُوا عُقْدَةَ النِّكَاحِ حَتَّى  
يَبْلُغَ الْكِتَابُ أَجَلَهُ ۗ وَاعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ  
يَعْلَمُ مَا فِي أَنْفُسِكُمْ فَاحْذَرُوهُ ۗ وَاعْلَمُوا  
أَنَّ اللَّهَ عَفُورٌ حَلِيمٌ ﴿٢٣٧﴾

100. Fëmijën mos e bëni mjet për t'i ushtruar presion njëri-tjetrit. Është një porosi shumë urtiplote. Shumë çifte e bëjnë këtë gabim dhe si rrjedhojë, i shkatërrojnë fëmijët si në aspektin shoqëror, ashtu edhe në aspektin moral. Veprimi i tillë është i barabartë me gjymtimin dhe vrasjen e fëmijëve. Kurani i Shenjtë ka bërë mirësi të madhe që na ndaloi nga një gjë e tillë.

237. Nuk është gjynah për ju nëse u jepni divorc grave përpara se t'i prekni ato ose përpara se t'ua keni caktuar shumën e dhuratës martesore.<sup>101</sup> Jepuni diçka që u sjell dobi; i pasuri sipas mundësisë së tij dhe i varfri sipas mundësisë së tij. Kjo dobi le të jetë në një masë të pranueshme, (kurse) për mirëbërësit kjo është e detyrueshme.

238. E nëse u jepni divorc përpara se t'i prekni por t'ua keni përcaktuar shumën e dhuratës martesore, duhet t'u jepni gjysmën e asaj që keni përcaktuar, përveçse nëse ato jua falin ose ju fal ai që ka në dorë kurorëzimin. Të falni është më afër druajtjes (ndaj Zotit). Mos harroni mirëbërësinë ndaj njëri-tjetrit. Allahu pa dyshim sheh mirë çdo gjë që bëni.

239. Ruajini namazet,<sup>102</sup> e (sidomos) namazin e mesit, dhe ngrihuni pranë Allahut duke qenë të bindur!<sup>103</sup>

240. Nëse keni frikë, (mund të falni) duke ecur ose duke hipur në mjet. E kur të jeni në paqe, kujtojeni Allahun në atë mënyrë siç ju ka mësuar Ai, që nuk e dinit (më përpara).

لَا جُنَاحَ عَلَيْكُمْ إِن طَلَقْتُمُ النِّسَاءَ مَا لَمْ تَمْسُوهُنَّ أَوْ تَفْرِضُوا لَهُنَّ فَرِيضَةً ۗ وَ مِعْوَهُنَّ عَلَى الْمَوْسِعِ قَدْرُهُ وَعَلَى الْمُقْتِرِ قَدْرُهُ مَتَاعًا بِالْمَعْرُوفِ ۗ حَقًّا عَلَى الْمُحْسِنِينَ ﴿٣٧﴾

وَإِن طَلَقْتُمُوهُنَّ مِنْ قَبْلِ أَنْ تَمْسُوهُنَّ وَقَدْ فَرَضْتُمْ لَهُنَّ فَرِيضَةً فِضْفُ مَا فَرَضْتُمْ إِلَّا أَنْ يَعْفُونَ أَوْ يَعْفُوا الَّذِي بِيَدِهِ عَقْدَةُ الزَّكَاحِ ۗ وَأَنْ تَعْفُوا أَقْرَبُ لِلتَّقْوَى ۗ وَلَا تَنْسُوا الْفَصْلَ بَيْنَكُمْ ۗ إِنَّ اللَّهَ بِمَا تَعْمَلُونَ بَصِيرٌ ﴿٣٨﴾

حُذِرُوا عَلَى الصَّلَوَاتِ وَالصَّلَاةِ الْوَسْطَىٰ ۗ وَقَوْمُوا لِلَّهِ قَنِينًا ﴿٣٩﴾

فَإِنْ خِفْتُمْ فَرِجَالًا أَوْ رُكْبَانًا ۖ فَإِذَا أَمْنْتُمْ فَاذْكُرُوا اللَّهَ كَمَا عَلَّمَكُم مَّا لَمْ تَكُونُوا تَعْلَمُونَ ﴿٤٠﴾

101. Dhurata martesore, pra *hak mehr* është pasuri e përcaktuar që dhëndri ka për detyrë t'ia japë nuses.

102. Ky ajet sjell porosinë për ta ruajtur namazin. Në një ajet tjetër Zoti thotë: “*namazi (të) ndalon nga imoraliteti dhe e pahijshmja*” (29:46). Pra, me këto fjalë Kurani na tregon se falja Islame nuk ka efekt të njëanshëm, por robi kur e ruan namazin e tij, edhe namazi e mbron atë nga imoraliteti dhe e pahijshmja. Nëse ti e ruan namazin, edhe namazi do të të ruajë ty.

103. Me fjalët *salat vusta*, pra *namazi i mesit* përgjithësisht kuptohet namazi i ikindisë, ndërkohë namazi i mesit mund të jetë çdo namaz që vjen gjatë punës. Pra, sa më shumë të jetë i angazhuar dikush me punë, aq më i rëndësishëm do të jetë për të namazi që vjen në atë kohë.

241. Dhe ata që vdesin midis jush dhe lënë pas bashkëshorte, keni detyrim në favor të grave të tyre që ato të kenë mjete për të jetuar në shtëpitë (e tyre) për një vit, pa i detyruar ndokush që të dalin nga ajo. Por nëse ato vetë shkojnë e marrin ndonjë vendim në mënyrë të pranueshme për jetën e tyre, ju nuk do të keni gjynah. Allahu është i Gjithëfuqishëm, i Urtë.

وَالَّذِينَ يُتَوَفَّوْنَ مِنْكُمْ وَيَذَرُونَ  
أَرْوَاجًا ۗ وَوَصِيَّةً لِّأَرْوَاجِهِمْ مَّتَاعًا إِلَى  
الْحَوْلِ غَيْرِ إِخْرَاجٍ ۚ فَإِنْ حَرَجْنَ فَلَا  
جُنَاحَ عَلَيْكُمْ فِي مَا فَعَلْنَ فِي أَنْفُسِهِنَّ  
مِنْ مَّعْرُوفٍ ۗ وَاللَّهُ عَزِيزٌ حَكِيمٌ ﴿٢٤١﴾

242. Edhe grave të divorcuara u takon që të sigurohen me mjete për të jetuar njerëzisht. Ky është një detyrim për të druajturit (ndaj Zotit).

وَالْمُطَلَّقَاتُ مَتَاعٌ بِالْمَعْرُوفِ ۗ حَقًّا عَلَى  
الْمُتَّقِينَ ﴿٢٤٢﴾

243. Kështu Allahu ju shpjegon qartë shenjat e Tij, që ju të kuptoni.<sup>104</sup>

كَذَلِكَ يُبَيِّنُ اللَّهُ لَكُمْ آيَاتِهِ لَعَلَّكُمْ  
تَعْقِلُونَ ﴿٢٤٣﴾

244. A nuk di për ata që ikën nga shtëpitë e tyre nga frika e vdekjes e ata ishin me mijëra?! Allahu u tha: “Vdisni!” e më pas Ai i ringjalli. Allahu me të vërtetë u jep bekime të mëdha njerëzve, por shumica e tyre nuk falënderojnë.<sup>105</sup>

أَلَمْ تَرَ إِلَى الَّذِينَ خَرَجُوا مِنْ دِيَارِهِمْ  
وَهُمْ أُلُوفٌ حَذَرَ الْمَوْتِ ۖ فَقَالَ لَهُمْ  
اللَّهُ مُوتُوا ۗ ثُمَّ أَحْيَاهُمْ ۗ إِنَّ اللَّهَ لَذُو  
فَضْلٍ عَلَى النَّاسِ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ  
لَا يَشْكُرُونَ ﴿٢٤٤﴾

245. Luftoni në rrugën e Allahut dhe dijeni se Allahu pa dyshim është Gjithëdëgjues, i Gjithëdijshëm.

وَقَاتِلُوا فِي سَبِيلِ اللَّهِ وَعَلِمُوا أَنَّ اللَّهَ  
سَمِيعٌ عَلِيمٌ ﴿٢٤٥﴾

104. D.m.th. Sheriati Islam i shpjegon porositë në atë mënyrë që përfshin mësim për çdo gjë të nevojshme dhe gjithashtu përmendja e tyre është në një formë që lexuesit të nxiten për të logjikuar dhe përsiatur, në mënyrë që të shpëtojnë nga ligësitë dhe dobësitë morale.

105. Në këtë ajet, porosia “Vdisni!” nuk nënkupton vdekje fizike, sepse vetëvrasia është e ndaluar dhe, së dyti, Kurani i Shenjtë shumë herë deklaroi shprehimisht se ai që largohet një herë nga kjo botë, nuk mund të kthehet më. Kuptimi i kësaj porosie ishte që ata t’u jepnin fund dëshirave të tyre, siç thuhet edhe në gjuhën e sufistëve “Vdisni para se t’ju vijë vdekja!”, që do të thotë, nënshtrojni Zotit, përpara se vdekja t’ju nënshtrojë.

246. Kush do t'i japë Allahut hua të mirë, që Ai t'ia kthejë duke e shumëfishuar atë?! Allahu e merr dhe e shton (pasurinë) dhe tek Ai do të ktheheni.

مَنْ ذَا الَّذِي يُقْرِضُ اللَّهَ قَرْضًا حَسَنًا  
فِيضِعْفَهُ لَهُ أَضْعَافًا كَثِيرَةً ۗ وَاللَّهُ يَقْبِضُ  
وَيَبْضُطُ ۖ وَإِلَيْهِ تُرْجَعُونَ ﴿٤٦﴾

247. A nuk e ke parë gjendjen e parisë së bijve të Izraelit pas Musait?! Kur ata i thanë një Profeti të tyre: “Na cakto një mbret që të luftojmë në rrugën e Allahut”. Ai tha: “Në mos ndodhtë që juve t’ju obligohet lufta e të mos luftoni!” Ata thanë: “E çfarë kemi ne që të mos luftojmë në rrugën e Allahut, ndërkohë jemi dëbuar nga shtëpitë tona dhe na janë ndarë edhe fëmijët?!” Por kur atyre iu obligua lufta, ata u kthyen mbrapsht, përveç disave prej tyre. Allahu i njeh mirë të padrejtët.

أَلَمْ تَرَ إِلَى الْمَلَآئِمِ مِنْ بَنِي إِسْرَائِيلَ مِنْ  
بَعْدِ مُوسَىٰ إِذْ قَالُوا لِنَبِيِّهِمْ ائْتِنَا  
مَلَكًا نُقَاتِلَ فِي سَبِيلِ اللَّهِ ۗ قَالَ هَلْ  
عَسَيْتُمْ إِنْ كُتِبَ عَلَيْكُمُ الْقِتَالُ أَلَّا تُقَاتِلُوا ۗ  
قَالُوا وَمَا لَنَا أَلَّا نُقَاتِلَ فِي سَبِيلِ اللَّهِ  
وَقَدْ أُخْرِجْنَا مِنْ دِيَارِنَا وَأَبْنَاءِنَا ۗ فَلَمَّا  
كُتِبَ عَلَيْهِمُ الْقِتَالُ تَوَلَّوْا إِلَّا قَلِيلًا  
مِّنْهُمْ ۗ وَاللَّهُ عَلِيمٌ بِالظَّالِمِينَ ﴿٤٧﴾

248. Dhe Profeti i tyre u tha: “Allahu ju ka caktuar Talutin si mbret”. Ata thanë: “Si mund të ketë ai mbretërinë mbi ne?! Jemi ne që kemi më shumë të drejtë sesa ai për mbretërinë; ai nuk gëzon as bollëkun e pasurisë!” (Profeti) tha: “Allahu pa dyshim që e ka zgjedhur mbi ju dhe e ka shtuar në dije e në trup. Allahu ia jep mbretërinë e Tij kujt të dojë dhe Allahu është Zgjerues, i Gjithëdijshëm.

وَقَالَ لَهُمْ نَبِيُّهُمْ إِنَّ اللَّهَ قَدْ بَعَثَ لَكُمْ  
طَالُوتَ ۗ قَالُوا أَنَّىٰ يَكُونُ لَهُ  
الْمُلْكُ عَلَيْنَا وَنَحْنُ أَحَقُّ بِالْمُلْكِ مِنْهُ  
وَلَمْ يَأْتِ سَعَةً مِنَ الْمَالِ ۗ قَالَ إِنَّ  
اللَّهَ اصْطَفَاهُ عَلَيْكُمْ وَزَادَهُ بَسْطَةً فِي  
الْعِلْمِ وَالْجِسْمِ ۗ وَاللَّهُ يُؤْتِي مَلَكَهُ مَنْ  
يَشَاءُ ۗ وَاللَّهُ وَاسِعٌ عَلِيمٌ ﴿٤٨﴾

249. Dhe Profeti i tyre u tha: “Një shenjë e mbretërisë së Tij është që juve do t’ju vijë arka në të cilën do të ketë qetësi prej Zotit tuaj si dhe trashëgimi të asaj që lanë populli

وَقَالَ لَهُمْ نَبِيُّهُمْ إِنَّ آيَةَ مُلْكِهِ أَنْ  
يَأْتِيَكُمُ التَّابُوتُ فِيهِ سَكِينَةٌ مِّن رَّبِّكُمْ  
وَبَقِيَّةٌ مِّمَّا تَرَكَ آلُ مُوسَىٰ وَآلُ هَارُونَ

i Musait dhe populli i Harunit. Engjëjt do ta bartin atë. Do të gjeni shenjë (madhore) në të, po të jeni besimtarë”.<sup>106</sup>

250. Kur Taluti u nis me gjithë ushtrinë, tha: “Allahu ka për t’ju sprovuar përmes një lumi. Kush pi nga ai, nuk është prej meje dhe kush nuk pi nga ai, përveç një grushti uji, është prej meje”. Të gjithë pinë ujë nga ai (lumë) përveç një pakice prej tyre. E kur ai dhe ata që besuan bashkë me të e tejkaluan lumin, (të pabindurit) thanë: “Ne sot nuk kemi fuqi të luftojmë me Xhalutin dhe ushtrinë e tij!” (Por) ata që ishin të bindur se do ta takonin Allahun, thanë: “Sa herë grupe të vogla, me urdhrin e Allahut, kanë triumfuar mbi grupe të mëdha! Allahu është me durimtarët”.

تَحْمِلُهُ الْمَلَائِكَةُ ۗ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَةً لِّكُمۡ إِن  
كُنْتُمْ مُّؤْمِنِينَ ﴿٢٥٠﴾

فَلَمَّا فَصَلَ طَالُوتُ بِالْجُنُودِ ۗ قَالَ إِنَّ  
اللَّهَ مُبْتَلِيكُمْ بِنَهَرٍ ۗ فَمَنْ شَرِبَ مِنْهُ فَلَيْسَ  
بِمِيَّ ۗ وَمَنْ لَّمْ يَطْعَمْهُ فَإِنَّهُ مِنِّي ۙ إِلَّا مَنْ  
اغْتَرَفَ غُرْفَةً بِيَدِهِ ۗ فَشَرِبُوا مِنْهُ إِلَّا  
قَلِيلًا مِّنْهُمْ ۗ فَلَمَّا جَاوَزَهُ هُوَ وَالَّذِينَ  
آمَنُوا مَعَهُ ۗ قَالُوا لَا طَاقَةَ لَنَا الْيَوْمَ  
بِجَالُوتَ وَجُنُودِهِ ۗ قَالَ الَّذِينَ يَظُنُّونَ  
أَنَّهُم مُّقْتَدُوا اللَّهَ ۗ كَمَ ۙ مَنْ فِئَةٍ قَلِيلَةٍ  
غَلَبَتْ فِئَةً كَثِيرَةً ۗ بِإِذْنِ اللَّهِ ۗ وَاللَّهُ مَعَ  
الصَّابِرِينَ ﴿٢٥١﴾

106. Kuptimi i parë i fjalës *tabut* është *arkë, sënduk, varkë* (Akraab), por në kuptimin metaforik *tabut* i thonë edhe *zembrës* (Mufredat). Edhe në këtë ajet fjala *tabut* (arkë) nënkupton zemrën, sepse dihet se qetësia qëndron në zemër dhe jo nëpër arka, por në zemrën që e mbajnë engjëjt duke e ushqyer atë me kurajë dhe me energji pozitive. Andaj, kuptimi është – Engjëjt do t’i nxisnin ndjekësit e Talutit për të bërë sakrificë madhore. Pastaj në arkë do të kishte: “trashëgimi (*bekijjeh*) të asaj që lanë populli i Musait dhe populli i Harunit”. Në arabisht kur thuhet filani është *bekijjeh* në popullin e tij, nënkupton se ai është ndër më të mirët e popullit të vet. Me këtë kuptim edhe Kurani e përdor këtë fjalë (18:47). Edhe Zekerija<sup>as</sup> iu lut Zotit që fëmija i tij ta trashëgonte atë dhe familjen e Jakubit (19:7), ndërkohë që Jakubi<sup>as</sup> kishte mijëra vjet që kishte ndërruar jetë. Andaj, trashëgimi e familjes, pra e popullit të Musait dhe e Harunit nënkupton që shokët e Talutit do të kishin virtyte që kanë pasur familja e këtyre të dyve. Kështu që, Profeti i kohës duke iu drejtuar akuzuesve u tha – Zoti i di më mirë fuqitë e fshehta, andaj, për sa kohë që Ai e zgjodhi Talutin, Taluti pa dyshim që është më i mirë se ju; dhe së dyti, drejtimi nuk bëhet me para, por me dije dhe sakrificë, që Taluti i ka të dyja më shumë se ju. Fjalët në ajetin e mëparshëm “*e ka shtuar në dije e në trup*” nuk do të thotë se e ka shëndoshur, por se i ka dhënë forcën e durimit dhe të sakrificuarit. Përveç kësaj, një tjetër shenjë që Allahu i dha atij është që edhe ndjekësit e tij do të forcoheshin shpirtërisht dhe moralisht dhe me ndihmën e Zotit, atyre do t’u qetësoheshin zemrat dhe ata do të gëzonin druajtjen ndaj Zotit që gëzonte xhemati i Musait dhe i Harunit<sup>as</sup>.



251. E kur ata dolën për t'u përballur me Xhalutin dhe ushtrinë e tij, thanë: “O Zoti ynë! Na jep durim, na forco këmbët dhe na ndihmo kundër popullit mohues!”

252. Ata i mundën me urdhrin e Allahut. Daudi e vrau Xhalutin dhe Allahu atij i dha sundimin, urtësinë dhe i mësoi gjithçka që deshi. Sikur të mos i zmbropste Allahu disa njerëz prej disa të tjerëve, do të çrregullohej toka. Por Allahu zotëron bekime të mëdha për botët.<sup>107</sup>

253. Këto janë ajete të Allahut që të lexojmë ty me vërtetësi dhe ti pa dyshim je ndër të Dërguarit.

Xhuzi 3

254. Këta janë të Dërguarit që u kemi dhënë epërsi, disave mbi disa të tjerë. Prej tyre ka nga ata që Allahu u foli (drejtpërdrejt) dhe ka të tjerë që i ngriti në pozitë.<sup>108</sup> Dhe Isait të birit të Merjemes i dhamë shenja të qarta dhe e ndihmuam me Shpirtin e shenjtë. Sikur të donte Allahu, njerëzit që erdhën pas tyre nuk do

وَلَمَّا بَرَزُوا لِجَلُوتَ وَجُوْدِهِ قَالُوا رَبَّنَا  
أَفْرِغْ عَلَيْنَا صَبْرًا وَثَبِّتْ أقدامَنَا وَأَنْصُرْنَا  
عَلَى الْقَوْمِ الْكَافِرِينَ ۝

فَهَرَمُوهُمْ بِإِذْنِ اللَّهِ ۖ وَقَتَلَ دَاوُدُ جَالُوتَ  
وَأَتَاهُ اللَّهُ الْمُلْكَ وَالْحِكْمَةَ وَعَلَّمَهُ مَا  
يَشَاءُ ۗ وَلَوْ لَا دَفَعُ اللَّهُ النَّاسَ بَعْضَهُمْ  
بِبَعْضٍ لَفَسَدَتِ الْأَرْضُ وَلَكِنَّ اللَّهَ  
ذُو فَضْلٍ عَلَى الْعَالَمِينَ ۝

تِلْكَ آيَاتُ اللَّهِ تَنْتُوها عَلَيْكَ بِالْحَقِّ ۗ  
وَإِنَّكَ لَمِنَ الْمُرْسَلِينَ ۝

تِلْكَ الرُّسُلُ فَضَّلْنَا بَعْضَهُمْ عَلَى  
بَعْضٍ مِنْهُمْ مَنْ كَلَّمَ اللَّهُ وَرَفَعَ  
بَعْضَهُمْ دَرَجَاتٍ ۗ وَآتَيْنَا عِيسَى ابْنَ  
مَرْيَمَ الْبَيِّنَاتِ وَأَيَّدْنَاهُ بِرُوحِ الْقُدُسِ ۗ  
وَ لَوْ شَاءَ اللَّهُ مَا أَقْتَلَ الَّذِينَ مِنْ  
بَعْدِهِمْ مِنْ بَعْدِ مَا جَاءَتْهُمْ الْبَيِّنَاتُ

107. Ajetet 248-252, nëse lexohen me vëmendje, del që Taluti nuk është tjetërkush përveç Hazret Daudit<sup>as</sup>, që Xhalutin e kishte kundërshtar. Në kontekst është e qartë se “Daudi e vrau Xhalutin”, dhe edhe Xhaluti që është përmendur në fillim është pikërisht ky që u vra nga Hazret Daudi. Arsyeja se përse në fillim të këtyre ajeteve Hazret Daudi ka një emër tjetër, duket se Zoti ia dhuroi profetërinë pasi ai triumfoi mbi Xhalutin, siç tha në këtë ajet: “dhe Allahu atij i dha sundimin, urtësinë”. Një kuptim i urtësisë është edhe profetëri pa Sheriat.

108. Ajeti nuk nënkupton që të ketë profetë me të cilët Allahu të mos komunikojë, ose të ketë të tillë prej tyre, të cilët të mos jenë të lartësuar shpirtërisht. Kuptimi i ajetit është që ka dy lloje të Profetëve: (a) ata që sjellin një ligj a shariat të ri, të cilët këtu janë kategorizuar si ata që Allahu u ka komunikuar ligjet, dhe (b) ata që janë të lartësuar shpirtërisht, por që atyre Allahu nuk u ka komunikuar ligjet. Transmetohet se i Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> ka thënë se Hazret Ademi<sup>as</sup> ishte Profeti i parë dhe ishte Profeti të cilit Allahu i komunikoi ligjet (*nebijun mukel-lemun*) (Musned Ahmed, nr. 21546 e 21552).

të vrisnin njëri-tjetrin pasi u kishin ardhur shenjat e qarta, por ata ranë në kundërshti. Kështu, prej tyre kishte edhe nga ata që besuan, edhe nga ata që mohuan. Sikur të donte Allahu, ata nuk do të vrisnin njëri-tjetrin, por Allahu bën atë që do.

255. O ju që besuat! Shpenzoni nga ajo që ju kemi dhënë, përpara se të vijë dita kur nuk do të ketë as tregti, as miqësi e as ndërmjetësim. Janë mohuesit ata që janë të padrejtë.

256. Allahu; nuk ka të adhurueshëm tjetër përveç Tij. I Gjalli, i Qëndrueshmi. Atë nuk e zë as dremitja e as gjumi. E Atij është gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në tokë. Kush mund të ndërmjetësojë pranë Tij, pa lejen e Tij?! Ai e di gjithçka që është para tyre dhe gjithçka që është pas tyre. Ata nuk mund të zotërojnë asgjë nga dija e Tij, përveç asaj që Ai do. Sundimi i Tij shtrihet mbi qiejt e mbi tokën. Ruajtja e të dyjave nuk e lodh Atë dhe Ai është i Larti, i Madhërishtmi.<sup>109</sup>

وَلَكِنْ اخْتَلَفُوا فَمِنْهُمْ مَنْ آمَنَ وَمِنْهُمْ  
مَنْ كَفَرَ ۗ وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ مَا اقْتَتَلُوا ۗ  
وَلَكِنَّ اللَّهَ يَفْعَلُ مَا يُرِيدُ ۝٣٦

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا أَنْفِقُوا مِمَّا رَزَقْنَاكُمْ  
مِّنْ قَبْلِ أَنْ يَأْتِيَ يَوْمٌ لَا بَيْعَ فِيهِ  
وَلَا حُلَّةَ ۗ وَلَا شَفَاعَةَ ۗ وَالْكَافِرُونَ هُمُ  
الظَّالِمُونَ ۝٣٥

اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ ۚ الْحَيُّ الْقَيُّومُ ۚ لَا  
تَأْخُذُهُ سِنَةٌ وَلَا نَوْمٌ ۗ لَهُ مَا فِي السَّمَوَاتِ  
وَمَا فِي الْأَرْضِ ۗ مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ  
إِلَّا بِإِذْنِهِ ۗ يَعْلَمُ مَا بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَمَا  
خَلْفَهُمْ ۗ وَلَا يُحِيطُونَ بِشَيْءٍ مِّنْ عِلْمِهِ  
إِلَّا بِمَا شَاءَ ۚ وَسِعَ كُرْسِيُّهُ السَّمَوَاتِ  
وَالْأَرْضَ ۗ وَلَا يَئُودُهُ حِفْظُهُمَا ۗ وَهُوَ  
الْعَلِيُّ الْعَظِيمُ ۝٣٦

109. Ky ajet njihet si *ajetul-kursij* dhe konsiderohet si një nga ajetet më të rëndësishme, pasi përshkruan përsosmërisht Njëshmërinë e Zotit dhe atributet e Tij madhështore. Profeti<sup>savs</sup> raportohet të ketë thënë se *ajetul-kursiji* është maja e të gjitha ajeteve të Kuranit (Tirmidhi, nr. 2878). Ajeti paraardhës u kërkon muslimanëve të bëjnë sakrifica. Megjithatë, ata janë të bindur se vetëm sakrificat e tyre nuk sjellin fitoren apo rezultate të qëndrueshme. Ky ajet i përgjigjet kësaj dileme duke thënë se – ju keni një Allah, të Gjallë dhe të Qëndrueshëm, që juve do t’ju jap jetë dhe qëndrueshmëri. Arsyeja pse askush nuk do të lejohet të ndërmjetësojë për asnjë person, përveçse me lejen e Zotit, është se asnjë njeri nuk e di se çfarë është në mendjen e tjetrit, andaj askush prej njerëzve nuk është në gjendje të ndërmjetësojë për tjetrin përpara Zotit. Vetëm Zoti i di të fshehtat e zemrave të njerëzve dhe për këtë arsye nuk mund të ketë ndërmjetësim, veçse me lejen e Tij, sepse vetëm Ai e di se kush e meriton ndërmjetësimin.

257. Nuk ka imponim në fe. Tashmë është e dalluar e drejta nga e shtrembëta. Ai që mohon djallin dhe beson në Allah, ka kapur lidhjen më të fortë që nuk mund të këputet. Allahu është Gjithëdhëgjues, i Gjithëdhijshëm.<sup>110</sup>

258. Allahu është Mik i atyre që besuan; Ai i nxjerr ata nga errësirat në dritë. E ata që mohuan, djajtë janë miq të tyre, të cilët i nxjerrin nga drita në errësira. Të tillë janë banorët e zjarrit, në të cilin do të mbesin gjatë.

259. A nuk ke menduar për atë që u fjalos me Ibrahimin rreth Zotit të tij që Allahu ia kishte dhënë sundimin?! Kur Ibrahim tha: “Zoti im është Ai që jep jetë dhe vdekje”, ai i tha: “(Edhe) unë jap jetë dhe vdekje”. Ibrahim tha: “Allahu sjell diellin nga lindja, sille ti pra nga perëndimi!” Atëherë mohuesi mbeti gojëhapur. Allahu nuk i udhëzon njerëzit e padrejtë.

260. Ose për shembullin e atij që kaloi pranë një qyteze që ishte rrënuar përmbys?! Ai tha: “Vallë, si mund ta ringjallë Allahu këtë pas

لَا اِكْرَاهَ فِي الدِّينِ ۗ قَدْ تَبَيَّنَ الرُّشْدُ مِنَ  
الْغَيِّ ۗ فَمَنْ يَكْفُرْ بِالطَّاغُوتِ وَيُؤْمِنْ  
بِاللّٰهِ فَقَدْ اسْتَمْسَكَ بِالْعُرْوَةِ الْوُثْقَىٰ  
لَا انفِصَامَ لَهَا ۗ وَاللّٰهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ ﴿٥٧﴾

اللّٰهُ وَلِيُّ الَّذِينَ اٰمَنُوْا ۙ يُخْرِجُهُمْ مِّنَ  
الظُّلُمٰتِ اِلَى النُّوْرِ ۗ وَالَّذِيْنَ كَفَرُوْا  
اَوْ لِيَهُمُ الطَّاغُوتُ ۙ يُخْرِجُوهُمْ مِّنَ  
النُّوْرِ اِلَى الظُّلُمٰتِ ۗ اُولٰٓئِكَ اَصْحٰبُ النَّارِ  
ۗ هُمْ فِيْهَا خٰلِدُوْنَ ﴿٥٨﴾

اَلَمْ تَرَ اِلَى الَّذِيْ حٰجَّ اِبْرٰهِيْمَ فِى رِيْبَةٍ  
اَنْ اَتٰهُ اللّٰهُ الْمَلِكُ ۗ اِذْ قَالَ اِبْرٰهِيْمُ رَبِّىْ  
الَّذِىْ يُعْبٰى وَيُمَيِّتُ ۗ قَالَ اَنَا اَخِىْ وَامِيْتُ ۗ  
قَالَ اِبْرٰهِيْمُ فَاِنَّ اللّٰهَ يٰٓاْتِى بِالشَّمْسِ مِنْ  
الْمَشْرِىْقِ فَاَتَ بِهَا مِنَ الْمَغْرِبِ فَبُهِتَ  
الَّذِىْ كَفَرَ ۗ وَاللّٰهُ لَا يَهْدِى الْقَوْمَ  
الظّٰلِمِيْنَ ﴿٥٩﴾

اَوْ كَالَّذِى مَرَّ عَلٰى قَرْيَةٍ وَّهِيَ خَاوِيَةٌ  
عَلٰى عُرُوْسِهَا ۗ قَالَ اِنِّىْٓ اُنۢبِىٓ هٰذِهِ اللّٰهُ بَعْدَ

Klauzola, “ata nuk mund të zotërojnë asgjë nga dija e Tij”, do të thotë se njohuria e Zotit është e pakufizuar; ndërsa njohuritë e të tjerëve, kushdo qofshin ata, janë të kufizuara. Fjala *kursij* mund të nënkuptojë dijen, sundimin dhe fuqinë.

110. Ky ajet na ndalon kategorikisht që t’ia ndërrojmë besimin tjetrit me imponim. “Nuk ka imponim në fe” do të thotë se nuk duhet të ketë asnjë lloj imponimi në çështjet e besimit. Atij që i është bërë e qartë e vërteta, shembulli i tij është si ai që ka kapur një dorezë të fortë. Dora e tij mund të pritët, por nuk mund të shképutët nga doreza.

vdekjes së saj?!” Atëherë Allahu i dha vdekje njëqindvjeçare, pastaj e ngriti atë (dhe) e pyeti: “Sa kohë ke qëndruar (në këtë gjendje)?” Ai tha: “Kam qëndruar një ditë, ose një pjesë të ditës”. (Allahu) tha: “Ti ke qëndruar njëqind vjet. Shikoje pra ushqimin dhe pijen tënde që nuk janë prishur dhe shiko pak edhe gomarin tënd. Kjo (pamje) është që të të bëjmë ty një shenjë për njerëzit. Shikoji edhe eshtrat se si i ngremë e më pas si i veshim me mish”. Kur atij iu qartësua, tha: “E kuptova që Allahu pa dyshim është i Plotfuqishëm për çdo gjë”.<sup>111</sup>

261. Dhe kur Ibrahim i tha: “O Zoti im! Më trego se si i ringjall të vdekurit?” (Zoti) tha: “A nuk beson?” Ai tha: “Patjetër që po, por (dua) që të më qetësohet zemra”. (Zoti) tha: “Merr katër zogj dhe bëji (manarë) që të vijnë pas teje. Pastaj secilin prej tyre vëre në çdo kodër dhe më pas thirri. Do të të vijnë me shpejtësi. Dije se Allahu është Mbizotërues, i Urtë.”<sup>112</sup>

مَوْتَهَا ۚ فَأَمَّا تِلْكَ الْمَاءَةُ عَاوِرٌ ثُمَّ بَعَثَهُ ۖ  
 قَالَ كَمْ لَبِثْتَ ۖ قَالَ لَبِثْتُ يَوْمًا أَوْ بَعْضَ  
 يَوْمٍ ۖ قَالَ بَلْ لَبِثْتَ مِائَةَ عَاوِرٍ فَانظُرْ  
 إِلَىٰ طَعَامِكَ وَشَرَابِكَ لَمْ يَتَسَنَّهٖ ۗ  
 وَانظُرْ إِلَىٰ حِمَارِكَ وَلِنَجْعَلَ آيَةً لِّلنَّاسِ  
 وَانظُرْ إِلَىٰ الْعِظَامِ كَيْفَ نُنشِزُهَا ثُمَّ  
 نَكْسُوهَا لَحْمًا ۖ فَلَمَّا تَبَيَّنَ لَهُ ۗ قَالَ أَعْلَمُ  
 أَنَّ اللَّهَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿٢٦١﴾

وَإِذْ قَالَ إِبْرَاهِيمُ رَبِّ ارْنِي كَيْفَ تُحْيِي  
 الْمَوْتَىٰ ۖ قَالَ أَوَلَمْ تُؤْمِنُ ۖ قَالَ بَلَىٰ  
 وَلَكِن لِّيَطْمَئِنُّ قَلْبِي ۖ قَالَ فَخُذْ أَرْبَعَةً  
 مِّنَ الطَّيْرِ فَصُرْهُنَّ إِلَيْكَ ثُمَّ اجْعَلْ عَلَىٰ  
 كُلِّ جَبَلٍ مِّنْهُنَّ جُزْءًا ۖ ثُمَّ ادْعُهُنَّ يَأْتِيَنَّكَ  
 ۚ سَعْيًا ۖ وَاعْلَمَنَّ أَنَّ اللَّهَ عَزِيزٌ حَكِيمٌ ﴿٢٦٢﴾

111. Ky ajet në lexim të parë të jep përshtypjen, siç e kuptojnë edhe komentuesit në përgjithësi, që Zoti i dha vdekje njëqindvjeçare për njëqind vjet dhe pastaj kur e ringjalli, ushqimi, pija, gomari i tij ishin në gjendje të mirë. Por me një lexim më të thellë na bëhet e qartë se kuptimi i këtij ajeti është që në gjumin e një nate, atij i janë treguar se çfarë do të ndodhte për njëqind vite të tjera, por kur ai u zgjua, Zoti i Lartësuar i tha që të shikonte se edhe gomari i tij, edhe ushqimi dhe pija e tij ishin në gjendje të mirë, ashtu siç kanë qenë një natë përpara.

112. Komentuesit në përgjithësi gabojnë kur e interpretojnë këtë ajet. Sipas tyre, Zoti e porositi Hazret Ibrahim<sup>as</sup> të merrte katër zogj, t'i rriste e pastaj t'i bënte copë-copë dhe pastaj mishin e tyre të grirë ta vendoste nga pak në lindje, perëndim, jug e veri, pastaj t'i thërriste. Por, gjuha arabe nuk e pranon një kuptim të tillë të këtij ajeti. Folja *surrhun-na ilejke* ka këto kuptime: *أَمْلَهُنَّ مِنَ الصَّوْرِ أَيْ الْمَيْلِ* domethënë, folja *sur* rrjedh nga fjala *saur* që do të thotë *bëj dikë a diçka që të anojë nga diku dhe surhun-ne ilejke* do të thotë *bëji për vete ose bëji që ato të anojnë nga ti (ose) bëji manarë*. Disa thonë: *surrhun-ne ilejke* do të thotë *thirri që të vijnë drejt teje!*

262. Shembulli i atyre që shpenzojnë pasuritë e tyre në rrugën e Allahut është si ai i farës që nxjerr shtatë kallinj, (dhe) në çdo kalli ka nga njëqind fara. Allahu ia shton (edhe më shumë) kujt të dojë. Allahu është Zgjerues, i Gjithëdijshëm.

مَثَلُ الَّذِينَ يُنْفِقُونَ أَمْوَالَهُمْ فِي سَبِيلِ  
اللَّهِ كَمَثَلِ حَبَّةٍ أَنْبَتَتْ سَبْعَ سَنَابِلٍ فِي كُلِّ  
سُنْبُلَةٍ مِائَةٌ حَبَّةٌ ۗ وَاللَّهُ يُضِعِفُ لِمَنْ  
يَشَاءُ ۗ وَاللَّهُ وَاسِعٌ عَلِيمٌ ﴿١٦٦﴾

263. Ata që shpenzojnë pasuritë e tyre në rrugën e Allahut dhe nuk kërkojnë mirënjohje për to e as nuk lëndojnë dikë me anë të tyre, do ta kenë shpërblimin te Zoti i tyre dhe ata nuk do të kenë as frikë dhe as nuk do të pikëllohen.

الَّذِينَ يُنْفِقُونَ أَمْوَالَهُمْ فِي سَبِيلِ اللَّهِ  
ثُمَّ لَا يَسْئَلُونَ مَا أَنْفَقُوا مَنًّا وَلَا أَدَىٰ ۗ  
لَهُمْ أَجْرُهُمْ عِنْدَ رَبِّهِمْ ۖ وَلَا خَوْفٌ  
عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ ﴿١٦٧﴾

264. Një fjalë e mirë dhe një falje është më e mirë sesa një lëmoshë që përcillet me lëndim. Allahu është i Vetëmjaftueshëm, i Përmbajtur.

قَوْلٌ مَّعْرُوفٌ وَمَغْفِرَةٌ خَيْرٌ مِّنْ صَدَقَةٍ  
يَتَّبِعُهَا أَدَىٰ ۗ وَاللَّهُ غَنِيٌّ حَلِيمٌ ﴿١٦٨﴾

265. O ju që besuat! Mos i prishni lëmoshat tuaja duke kërkuar mirënjohje dhe duke shkaktuar lëndim, si ai që shpenzon pasurinë e vet për t'ua treguar njerëzve dhe që nuk beson në Allah dhe në Ditën e *Ahiretit*. Pra, shembulli i tij është si i shkëmbit që ka (shtresë) dheu, të cilit i bie një shi i madh që e lë të zhveshur. Ata nuk zotërojnë fuqi mbi asgjë që fitojnë. Allahu nuk i përuddh njerëzit mohues.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَبْطُلُوا صَدَقَتَكُمْ  
بِالْمَنِّ وَالْأَدَىٰ ۗ كَالَّذِي يُنْفِقُ مَالَهُ رِئَاءَ  
النَّاسِ وَلَا يُؤْمِنُ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ ۗ  
فَمَثَلُهُ كَمَثَلِ صَفْوَانٍ عَلَيْهِ تُرَابٌ فَأَصَابَهُ  
وَابِلٌ فَتَرَكَهُ صَلْدًا ۗ لَا يَقْدِرُونَ عَلَىٰ  
شَيْءٍ مِّمَّا كَسَبُوا ۗ وَاللَّهُ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ  
الْكَافِرِينَ ﴿١٦٩﴾

266. Dhe ata që shpenzojnë pasuritë e tyre për të kërkuar pëlqimin e Allahut

وَمَثَلُ الَّذِينَ يُنْفِقُونَ أَمْوَالَهُمْ ابْتِغَاءَ  
مَرْضَاتِ اللَّهِ وَتُبَيِّنًا مِّنْ أَنْفُسِهِمْ كَمَثَلِ

(Mufredat, zëri: *suver*). Pra, pyetja e Ibrahimit<sup>as</sup> ishte për ringjalljen e të vdekurve shpirtërorë dhe Allahu ia tregoi metodën si të vepronte. Kështu shpirtat që duan të kenë dashuri ndaj Zotit të Lartësuar, kthehen vetvetishëm tek Ai, kur Ai i thërret. Kjo tregon që krijesa e ka një tërheqje të fshehtë drejt Krijuesit.

dhe për t'u dhënë qëndrueshmëri disave prej tyre, i shëmbëlajnë një kopshti që ndodhet në rrafshnaltë, të cilit kur i bie shi i madh, ai jep fryt të dyfishtë. E nëse nuk i bie shi i madh, i mjafton një vesë. Allahu sheh mirë çdo gjë që bëni.

267. A do të donte ndonjë prej jush që të kishte një kopsht me hurma e rrush, nën të cilin të rridhnin lumenj dhe ai të gëzonte çdolloj frute prej tij, ndërkohë atë ta zinte pleqëria, kurse fëmijët ende t'i kishte të dobët (e të vegjël), e atëherë (kopshtin) t'ia kaplonte një vorbull me zjarr e t'ia digjte?! Kështu Allahu ju shpjegon shenjat (e Tij) që ju të reflektoni.

268. O ju që besuat! Shpenzoni nga gjërat e mira që keni fituar dhe prej atyre që kemi nxjerrë për ju nga toka. Dhe gjatë shpenzimeve (në rrugën e Allahut) mos i përzieni me diçka të papastër, të cilën ju vetë nuk do ta pranoni, veçse të turpëruar. Djeni se Allahu është i Vetëmjaftueshëm, i Lavdërueshëm.

269. Djalli ju frikëson nga varfëria dhe ju urdhëron shturjen, kurse Allahu ju premton falje dhe bekime prej Tij dhe Allahu është Zgjerues, i Gjithëdijshëm.

270. Ai ia jep urtësinë kujt të dojë, dhe atij që i është dhënë urtësia, i është dhënë një mirësi e madhe. Vetëm të mençurit e kuptojnë.

جَنَّتُمْ بِرَبْوَةٍ أَصَابَهَا وَابِلٌ فَآتَتْ أُكْلَهَا  
ضَعْفَيْنِ ۚ فَإِنْ لَّمْ يُصِبْهَا وَابِلٌ فَطَلَّ ۗ  
وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ بَصِيرٌ ﴿٢٦٧﴾

أَيُّودٌ أَحَدَكُمُ أَنْ تَكُونَ لَهُ جَنَّةٌ مِّنْ نَّخِيلٍ  
وَأَعْنَابٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ لَهُ فِيهَا  
مِنْ كُلِّ الثَّمَرَاتِ ۗ وَأَصَابَهُ الْكِبَرُ وَلَهُ  
ذُرِّيَّةٌ ضُعَفَاءُ ۗ فَأَصَابَهَا إِعْصَارٌ فِيهِ نَارٌ  
فَأَحْتَرَقَتْ ۗ كَذَلِكَ يَبَيِّنُ اللَّهُ لَكُمْ الْآيَاتِ  
ۚ لَعَلَّكُمْ تَتَفَكَّرُونَ ﴿٢٦٨﴾

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا أَنْفِقُوا مِنْ طَيِّبَاتِ مَا  
كَسَبْتُمْ وَمِمَّا أَخْرَجْنَا لَكُمْ مِنَ الْأَرْضِ  
وَلَا تَيَمَّمُوا الْخَبِيثَ مِنْهُ تُنْفِقُونَ وَلَسْتُمْ  
بِأَخْذِيهِ إِلَّا أَنْ تُغِصُّوا فِيهِ ۗ وَاعْلَمُوا  
أَنَّ اللَّهَ غَنِيٌّ حَمِيدٌ ﴿٢٦٩﴾

الشَّيْطَانُ يَعِدُكُمُ الْفَقْرَ وَ يَأْمُرُكُمْ  
بِالْفَحْشَاءِ ۗ وَاللَّهُ يَعِدُكُمْ مَغْفِرَةً مِنْهُ  
وَفَضْلًا ۗ وَاللَّهُ وَاسِعٌ عَلِيمٌ ﴿٢٧٠﴾

يُؤْتِي الْحِكْمَةَ مَنْ يَشَاءُ ۚ وَمَنْ يُؤْتَ  
الْحِكْمَةَ فَقَدْ أُوتِيَ خَيْرًا كَثِيرًا ۗ وَمَا  
يَذَّكَّرُ إِلَّا أُولُو الْأَلْبَابِ ﴿٢٧٠﴾

271. Çdo gjë që ju shpenzoni prej gjërave që janë të denja për të shpenzuar, ose bëni ndonjë be, Allahu e di atë. Dhe të padrejtët nuk kanë asnjë ndihmës.

272. Nëse i jepni haptas lëmoshat, është gjë e mirë, po ashtu, nëse i fshihni dhe u jepni nevojtarëve është më mirë për ju. Allahu do t'ju largojë shumë nga ligësitë tuaja dhe Ai sheh mirë çdo gjë që bëni.

273. Nuk je ti përgjegjës për udhëzimin e tyre, por Allahu udhëzon kë të dojë. Dhe çdo gjë të mirë që shpenzoni, është në dobinë tuaj. Ju nuk shpenzoni asgjë, përveçse për të kërkuar pëlqimin e Allahut. Dhe çdo gjë të mirë që shpenzoni, do t'ju rikthehet e gjitha dhe juve nuk do t'ju bëhet padrejtësi.

274. Ky shpenzim do të jetë për nevojtarët që u ngujuan në rrugë të Allahut, që nuk lëvizin dot në tokë. Për shkak të shmangies së tyre nga lypja, i padituri i pandehë për të pasur, (por) ti i njeh nga shenjat e tyre. Ata nuk u qepen njerëzve duke lypur. Dhe çdo gjë të mirë që shpenzoni, Allahu e di shumë mirë atë.<sup>113</sup>

وَمَا أَنْفَقْتُمْ مِنْ نَفَقَةٍ أَوْ نَذَرْتُمْ مِنْ  
نَذْرٍ فَإِنَّ اللَّهَ يَعْلَمُهُ ۗ وَمَا لِلظَّالِمِينَ مِنْ  
أَنْصَارٍ ﴿٣٧﴾

إِنْ تَبَدَّوْا الصَّدَقَاتِ فَعِمَّا هِيَ ۚ وَإِنْ تُخْفُوهَا  
وَتُوتُوهَا الْفُقَرَاءَ فَهُوَ خَيْرٌ لَكُمْ ۗ وَيَكْفُرُ  
عَنْكُمْ مِنْ سَيِّئَاتِكُمْ ۗ وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ  
خَبِيرٌ ﴿٣٨﴾

لَيْسَ عَلَيْكَ هُدَاهُمْ وَلَكِنَّ اللَّهَ يَهْدِي مَنْ  
يَشَاءُ ۗ وَمَا تُنْفِقُوا مِنْ خَيْرٍ فَلَا يُنْفِسْكُمْ  
وَمَا تَنْقُوتُمْ إِلَّا ابْتِغَاءَ وَجْهِ اللَّهِ ۗ وَمَا  
تُنْفِقُوا مِنْ خَيْرٍ يُؤَفَّ إِلَيْكُمْ وَأَنْتُمْ لَا  
تُظْلَمُونَ ﴿٣٩﴾

لِلْفُقَرَاءِ الَّذِينَ أُحْصِرُوا فِي سَبِيلِ اللَّهِ لَا  
يَسْتَطِيعُونَ ضَرْبًا فِي الْأَرْضِ يَحْسَبُهُمُ  
الْجَاهِلُ أَغْنِيَاءَ مِنَ التَّعَفُّفِ ۚ تَعْرِفُهُمْ  
بِسِيمَتِهِمْ ۗ لَا يَسْأَلُونَ النَّاسَ إِحْقَاقًا  
وَمَا تُنْفِقُوا مِنْ خَيْرٍ فَإِنَّ اللَّهَ بِهِ عَلِيمٌ ﴿٤٠﴾

113. Ajeti nga njëra anë i përgëzon ata që pavarësisht se janë nevojtarë, por janë krenarë, dhe si të tillë nuk i lejojnë vetes lypjen, dhe nga ana tjetër e dekurajon edhe lypjen. I Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> tha: “Dora e sipërme është më e mirë se dora e poshtme. Dora e sipërme është e dhënësit, kurse ajo e poshtme është e lypësit.” (Buhari, nr. 1429)

275. Ata që shpenzojnë pasuritë e tyre natën dhe ditën, fshehurazi dhe haptazi, e kanë shpërblimin te Zoti i tyre dhe ata nuk do të kenë as frikë e as nuk do të pikëllohen.<sup>114</sup>

الَّذِينَ يُنْفِقُونَ أَمْوَالَهُمْ بِاللَّيْلِ وَالنَّهَارِ  
سِرًّا وَعَلَانِيَةً فَلَهُمْ أَجْرُهُمْ عِنْدَ رَبِّهِمْ  
وَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ ﴿٣٧﴾

276. Ata që hanë kamatën nuk mund të qëndrojnë, veçse si ai të cilin e ka shtangur djalli me prekjen e tij. Kjo sepse ata thanë se edhe tregtia është si kamata. Por Allahu e lejoi tregtinë dhe e ndaloi kamatën. Atij që i vjen një këshillë prej Zotit të tij dhe ai frenohet, le ta mbajë atë që ka (marrë) në të kaluarën dhe çështja e tij është tek Allahu. Kurse ata që e përsërisin janë banorë të zjarrit, në të cilin do të mbesin gjatë.

الَّذِينَ يَأْكُلُونَ الرِّبَا لَا يَقُومُونَ إِلَّا  
كَمَا يَقُومُ الَّذِي يَتَخَبَّطُهُ الشَّيْطَانُ مِنَ  
الْمَسِّ ۚ ذَٰلِكَ بِأَنَّهُمْ قَالُوا إِنَّمَا الْبَيْعُ مِثْلُ  
الرِّبَا ۗ وَأَحَلَّ اللَّهُ الْبَيْعَ وَحَرَّمَ الرِّبَا ۗ  
فَمَنْ جَاءَهُ مَوْعِظَةٌ مِنْ رَبِّهِ فَانْتَهَى  
فَلَهُ مَا سَلَفَ ۗ وَأَمْرُهُ إِلَى اللَّهِ ۗ وَمَنْ  
عَادَ فَأُولَٰئِكَ أَصْحَابُ النَّارِ ۗ هُمْ فِيهَا  
خَالِدُونَ ﴿٣٨﴾

277. Allahu e fshin kamatën dhe i shton bamirësitë. Allahu nuk e do mosmirënjohësin, të ligun.

يَمْحَقُ اللَّهُ الرِّبَا وَيُرِي الصَّدَقَاتِ  
وَاللَّهُ لَا يُحِبُّ كُلَّ كَفَّارٍ أَثِيمٍ ﴿٣٩﴾

278. Ata që besuan, bënë të mira, falin namazin dhe japin zekatin, shpërblimi i tyre është te Zoti i tyre dhe ata nuk do të kenë frikë e as nuk do të pikëllohen.

إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ وَآقَامُوا  
الصَّلَاةَ وَآتَوُا الزَّكَاةَ لَهُمْ أَجْرُهُمْ عِنْدَ  
رَبِّهِمْ ۗ وَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ  
يَحْزَنُونَ ﴿٤٠﴾

279. O ju që besuat! Druajuni Allahut dhe lëreni atë që mbetet nga kamata nëse jeni (vërtet) besimtarë!

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَذَرُوا مَا  
بَقِيَ مِنَ الرِّبَا إِن كُنْتُمْ مُؤْمِنِينَ ﴿٤١﴾

114. Kurani thotë se veprat ose shpenzimet në rrugë të Allahut t'i bëni edhe fshehtas, edhe haptas. Nganjëherë edhe haptas, me qëllim që njerëzit e tjerë të nxiten duke parë një model të mirë. Njeriu fiton forcë kur sheh një model të mirë. Lexoni edhe 2:272.



280. E nëse nuk e bëni këtë, pranojeni shpalljen për luftë me Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Nëse pendoheni, juve ju takon kapitali i pasurive tuaja. As nuk do të dëmtoni (dikë) e as nuk do të dëmtoheni.

فَإِنْ لَّمْ تَفْعَلُوا فَأْذَنُوا بِحَرْبٍ مِنَ اللَّهِ  
وَأَنْتُمْ عَلَيْهِ وَإِنْ تُبْتُمْ فَلَكُمْ رُءُوسُ  
أَمْوَالِكُمْ لَا تَظْلِمُونَ وَلَا تُظْلَمُونَ ﴿٢٨٠﴾

281. Po që ngushtë dikush, duhet t'i jepet afat derisa të lehtësohet. Po ta falni atë, do të jetë mirë për ju, nëse e dini.

وَإِنْ كَانَ ذُو عُسْرَةٍ فَنَظِرَةٌ إِلَىٰ مَيْسَرَةٍ  
وَإِنْ تَصَدَّقُوا خَيْرٌ لَّكُمْ إِنْ كُنْتُمْ  
تَعْلَمُونَ ﴿٢٨١﴾

282. Druhuni prej asaj dite kur do të ktheheni tek Allahu. Më pas, çdo shpirti do t'i jepet ajo që ka fituar dhe askujt nuk do t'i bëhet padrejtësi.

وَأْتُوا يَوْمَ تُرْجَعُونَ فِيهِ إِلَى اللَّهِ  
ثُمَّ تُؤْتَىٰ كُلُّ نَفْسٍ مَّا كَسَبَتْ وَهُمْ  
لَا يُظْلَمُونَ ﴿٢٨٢﴾

283. O ju që besuat! Kur i merrni hua njëri-tjetrit për një afat të caktuar, shkruajeni. Duhet ta shënojnë atë me drejtësi një shkruer ndërmjet jush. Asnjë shkruer të mos refuzojë ta shkruajë, gjersa Allahu ia ka mësuar (shkrimin), pra, ai duhet ta shkruajë. Le t'ia diktojë ai që merr me përgjegjësi të drejtën (e tjetrit), të ketë druajtje ndaj Allahut, Zotit të tij, e të mos pakësojë asgjë në të. Nëse ai që ka në përgjegjësi të drejtën (e tjetrit) është mendjelehtë ose i dobët ose nuk ka mundësi të diktojë, le ta diktojë me drejtësi kujdestari i tij. Caktoni si dëshmitarë dy prej burrave tuaj. Nëse nuk gjeni dot dy burra, mund të caktoni një burrë e dy gra, për të cilat keni pëlqimin që ato të jenë dëshmitare. Kjo sepse nëse njëra prej tyre harron, t'ia kujtojë tjetra. Dëshmitarët nuk duhet të

يَأْتِيهَا الَّذِينَ أَمْوَالُهُمْ إِذَا تَدَايَيْتُمْ بِدِينٍ إِلَىٰ  
أَجَلٍ مُّسَمًّى فَاكْتُبُوهُ ۖ وَلْيَكْتُب بَيْنَكُمْ  
كَاتِبٌ بِالْعَدْلِ ۖ وَلَا يَأْبَ كَاتِبٌ أَنْ يَكْتُبَ  
كَمَا عَلَّمَهُ اللَّهُ فَلْيَكْتُبْ ۚ وَيُمْلِلِ الَّذِي  
عَلَيْهِ الْحَقُّ وَيَتَّقِ اللَّهَ رَبَّهُ وَلَا يَبْخَسَ  
مِنْهُ شَيْئًا ۚ فَإِنْ كَانَ الَّذِي عَلَيْهِ الْحَقُّ  
سَفِيهًا أَوْ ضَعِيفًا أَوْ لَا يَسْطِيعُ أَنْ يُمِلَّ  
هُوَ فَلْيَمْلِكْ وَرَئِيهِ بِالْعَدْلِ ۖ وَأَسْتَشْهِدُوا  
شَهِيدَيْنِ مِنْ رِجَالِكُمْ ۚ فَإِنْ لَمْ يَكُونَا  
رَجُلَيْنِ فَرَجُلٌ وَامْرَأَتَيْنِ مِمَّنْ تَرْضَوْنَ  
مِنَ الشَّهَادَةِ أَنْ تَصَلَّ أَحَدُهُمَا فَيُذَكَّرَ  
أَحَدُهُمَا الْآخَرَىٰ ۖ وَلَا يَأْبَ الشَّهَادَةَ إِذَا

refuzojnë kur të thirren. Mos përtoni ta shkruani (huan) me gjithë afatin e saj, edhe sikur të jetë e vogël ose e madhe. Kjo sjellje për ju është më e drejtë tek Allahu, më e sigurt për dëshmi dhe më e mirë që ju të mos bini në dyshime. Po, nuk është gjynah për ju të mos shkruani vetëm nëse shitblerja bëhet në vend, duke ia dorëzuar njëri-tjetrit atë që i takon. Kur bëni shitblerje (afatgjata), caktoni dëshmitar. Nuk duhet të dëmtohet as shkruesi e as dëshmitari. Po e dëmtuat, keni bërë mëkat të madh. Kijeni druajtjen ndaj Allahut dhe Allahu do t'ju mësojë. Allahu është i Gjithëdijshëm për çdo gjë.

284. E kur jeni në udhëtim dhe nuk gjeni dot ndonjë shkruer, merrni diçka si peng. Nëse njëri prej jush i lë ndonjë amanet tjetrit, ky i fundit duhet t'ia kthejë amanetin e të ketë druajtje ndaj Allahut, Zotit të tij. Mos e fshihni dëshminë. Ai që e fsheh, e ka zemrën mëkatore.<sup>115</sup> Allahu është i Gjithëdijshëm për atë që bëni ju.

285. E Allahut është çdo gjë që gjendet në qiej dhe çdo gjë që gjendet në tokë. Edhe nëse e zbuloni ose e fshihni atë që keni në zemrat tuaja, Allahu do t'ju kërkojë llogari për të. Atëherë Ai do të falë kë të dojë dhe do të ndëshkojë kë të dojë. Allahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë.

مَا دُعُوا<sup>ط</sup> وَلَا تَسْمُوا أَنْ تَكْتُمُوهُ صَغِيرًا  
أَوْ كَبِيرًا إِلَىٰ آجَلِهِ<sup>ط</sup> ذِكْرُكُمْ أَقْسَطُ عِنْدَ اللَّهِ  
وَأَقْوَمُ لِلشَّهَادَةِ وَأَدْنَىٰ أَلَّا تَرْتَابُوا إِلَّا  
أَنْ تَكُونُوا تِجَارَةً حَاضِرَةً تُدِيرُونَهَا  
بَيْنَكُمْ فَلَيْسَ عَلَيْكُمْ جُنَاحٌ أَلَّا تَكْتُمُوهَا<sup>ط</sup>  
وَأَشْهَدُوا إِذَا تَبَايَعْتُمْ<sup>ص</sup> وَلَا يُضَارَّ كَاتِبٌ  
وَلَا شَهِيدٌ وَإِنْ تَفَعَّلُوا فَإِنَّهُ فُسُوقٌ  
بِكُمْ<sup>ط</sup> وَاتَّقُوا اللَّهَ<sup>ط</sup> وَيَعْلَمِ اللَّهُ  
وَاللَّهُ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ ﴿٢٨٤﴾

وَإِنْ كُنْتُمْ عَلَىٰ سَفَرٍ وَلَمْ تَجِدُوا كَاتِبًا  
فَرِهْنِمْ مَقْبُوضَةً<sup>ط</sup> فَإِنْ مِنْ بَعْضِكُمْ بَعْضًا  
فَلْيُؤَدِّ الَّذِي أُؤْتِمِنَ أَمَانَتَهُ وَيُتَّقِ اللَّهَ  
رَبَّهُ<sup>ط</sup> وَلَا تَكْتُمُوا الشَّهَادَةَ<sup>ط</sup> وَمَنْ  
يَكْتُمْهَا فَإِنَّهُ إِثْمٌ قَلْبُهُ<sup>ط</sup> وَاللَّهُ بِمَا  
تَعْمَلُونَ عَلِيمٌ ﴿٢٨٥﴾

لِلَّهِ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ<sup>ط</sup> وَإِنْ  
تُبَدُّوا مَا فِي أَنْفُسِكُمْ أَوْ تُخْفَوْنَ بِحَاسِبِكُمْ  
بِهِ اللَّهُ<sup>ط</sup> فَيَعْفِرْ لِمَنْ يَشَاءُ وَيُعَذِّبْ مَنْ  
يَشَاءُ<sup>ط</sup> وَاللَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿٢٨٥﴾

115. Zemra i përngjan lumit, të cilit i bashkohen përrrenjtë e vegjël, që janë gjuha, syri dhe organe të tjera. Nëse përroi është i ndotur, mendohet që edhe lumi të jetë i ndotur. Andaj, nëse dikush e ka të papastër gjuhën, ose sytë, ose duart, etj., ai do ta ketë papastërtinë edhe në zemër.

286. I Dërguari besoi në atë që i është zbritur prej Zotit të tij dhe, edhe besimtarët po ashtu. Çdokush besoi në Allah, (në) engjëjt e Tij, (në) Librat e Tij dhe (në) të Dërguarit e Tij (duke thënë) “nuk bëjmë dallim midis asnjërit prej të Dërguarve”, dhe ata thanë: “Ne dëgjuam dhe iu bindëm. Na fal o Zoti ynë! Te Ti kthehemi ne!”

287. Allahu nuk ngarkon asnjë shpirt përtej fuqisë që ka.<sup>116</sup> E atij është ajo që ka fituar dhe mbi të do të bjerë ajo që ka bërë me vetëdije. O Zoti ynë! Mos na ndëshko nëse harrojmë ose gabojmë! O Zoti ynë! Mos na ngarko barrën që ua ngarkove atyre që ishin para nesh! O Zoti ynë! Mos na ngarko diçka që nuk mund ta mbartim! Na tolero, na fal dhe na mëshiro! Ti je Miku ynë. Andaj, na ndihmo kundër popullit mohues!

أَمَّنَ الرَّسُولُ بِمَا أُنزِلَ إِلَيْهِ مِنْ رَبِّهِ  
وَالْمُؤْمِنُونَ كُلٌّ آمَنَ بِاللَّهِ وَمَلَائِكَتِهِ  
وَكُتُبِهِ وَرُسُلِهِ لَا نُفَرِّقُ بَيْنَ أَحَدٍ  
مِّنْ رُّسُلِهِ وَقَالُوا سَمِعْنَا وَأَطَعْنَا  
غُفْرَانَكَ رَبَّنَا وَإِلَيْكَ الْمَصِيرُ ﴿٢٨٦﴾

لَا يُكَلِّفُ اللَّهُ نَفْسًا إِلَّا وُسْعَهَا لَهَا مَا  
كَسَبَتْ وَعَلَيْهَا مَا اكْتَسَبَتْ رَبَّنَا لَا  
تُؤَاخِذْنَا إِنْ نَسِينَا أَوْ أَخْطَأْنَا رَبَّنَا  
وَلَا تَحْمِلْ عَلَيْنَا إصْرًا كَمَا حَمَلْتَهُ عَلَى  
الَّذِينَ مِنْ قَبْلِنَا رَبَّنَا وَلَا تُحَمِّلْنَا مَا  
لَا طَاقَةَ لَنَا بِهِ وَاعْفُ عَنَّا وَاعْفِرْنَا  
وَارْحَمْنَا أَنْتَ مَوْلَانَا فَانصُرْنَا عَلَى الْقَوْمِ  
الْكَافِرِينَ ﴿٢٨٧﴾

116. Libri i Allahut synon lehtësi. Ky është mesazhi i ajetit. Përveç kësaj, ky ajet tregon edhe faktin që çdokush të cilit, në sy të Zotit, i është sqaruar e vërteta me argumente, do të gjykohet para Zotit në Ditën e Gjykimit. Kurse një që e mohon Islamin dhe e kundërshton atë, por në sy të Zotit, atij akoma nuk i janë sqaruar argumentet për të vërtetën, sipas këtij ajeti, në Ditën e Gjykimit, ai nuk do të dënohet. Pavarësisht se Libri i Allahut e quan atë *mohues*, sepse Libri i Allahut në këtë botë gjykon duke parë të jashtmen, dhe edhe ne e ndjekim metodën e Librit të Allahut duke e quajtur *mohues*. Megjithatë, neve nuk na takon t'i japim atij certifikimin e *shpëtim*it, pasi kjo çështje është në Dorën e Allahut, ku ne nuk kemi kompetenca të ndërhyjmë.

### Surja 3 – Ali Imran

Kjo sure është medinase dhe zbriti në vitin e tretë pas mërgimit. Bashkë me *bismillahin*, ajo ka 201 ajete.

Në këtë sure në mënyrë të veçantë përmendet grupi i tretë i përmendur në suren El-Fatiha si “*dāl-līn*” (të devijuar). Duke i referuar këtij grupi, në këtë sure përmendet rreth fillimit të krishterimit, lindjes së *Hazret Merjemes*, si dhe rreth lindjes së jashtëzakonshme të *Hazret Isait*, paqja qoftë mbi të dy. Kjo sure gjithashtu tregon se si Zoti kishte sjellje të veçantë mirëbërëse me *Hazret Merjemen*<sup>as</sup> dhe se si i siguronte ushqim nga e padukshmja. Duket sikur edhe *Hazret Zekerijasë*<sup>as</sup> i lindi dëshira për të pasur pasardhës të dëlirë pikërisht duke e vënë re dëlirësinë e *Hazret Merjemes*<sup>as</sup>.

Kjo sure sjell në pah mrekullitë e *Hazret Isait*<sup>as</sup>. Por Kurani i Shenjtë sqaron realitetin e mrekullive aq qartë sa keqkuptimet që dalin duke i lexuar mrekullitë e *Isait*<sup>as</sup> në Bibël, largohen vetvetiu. Kjo sure flet edhe rreth vdekjes së natyrshme të *Hazret Isait*<sup>as</sup>.

Përballë besëlidhjes (*mithak*-ut) që Zoti e bëri me bijtë e Izraelit (që u përmend në suren e mëparshme), në këtë sure gjejmë “besëlidhjen me Profetët” (*mithakun nebijjīn*), pra, besëlidhje që Zoti bëri me të gjithë Profetët, dhe sipas së cilës, nëse do të vijnë të dërguar të tjerë pas tyre, që t’ua vërtetojnë mësimet dhe të veprojnë sipas tyre, atëherë popujt e Profetëve duhet të jenë të gatshëm t’i ndihmojnë ata. Kjo është pikërisht ajo besëlidhje që përmendet edhe një herë në suren El-Ahzab dhe ku thuhet që ajo ishte marrë edhe nga *Hazret Profeti Muhammed*, paqja qoftë mbi të.

Përveç çështjeve të tjera, kjo sure hedh dritë edhe mbi filozofinë e sakrificave financiare dhe thotë se sakrifica juaj kurrë nuk mund të pranohet derisa të sakrifikoni në rrugën e Zotit atë që është më e dashura dhe më e mira për ju.

Kjo sure gjithashtu sjell në dritë fitoren e mrekullueshme të *Hazret Profetit Muhammed*<sup>savvs</sup> në betejën e Bedrit, që do t’i paraprinte fitore pas fitoreje, po ashtu edhe betejën e Uhudit duke treguar sesi sahabët e tij u flijuan si kurban, por nuk e lëshuan dorën e të Dërguarit të Allahut<sup>savvs</sup>, duke e ripërtërirë kështu sakrificën e *Hazret Ismailit*<sup>as</sup>.

1. Me emrin e Allahut, të Gjithë-mëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ۝

2. *Elif.Lam.Mim.* (Unë jam Allahu, më i Dijshmi.)

أَلَمْ ۝

3. Allahu. Nuk ka të adhureshëm tjetër përveç Tij. I Gjalli, i Qëndrueshmi.

اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ ۝

4. Ai ty të zbriti Librin me të drejtë, si vërtetues të asaj që ka qenë para tij, Ai zbriti edhe Teuratin edhe Inxhilin

نَزَّلَ عَلَيْكَ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ مُصَدِّقًا لِمَا بَيْنَ يَدَيْهِ وَأَنزَلَ التَّوْرَةَ وَالْإِنْجِيلَ ۝

5. si udhërrëfyes për njerëzit më parë. Ai zbriti Dalluesin. Sigurisht, ata që mohuan shenjat<sup>1</sup> e Allahut do të kenë ndëshkim të rëndë dhe Allahu është i Plotfuqishëm, Hakmarrës.

مَنْ قَبْلُ هَدَى لِلنَّاسِ وَأَنزَلَ الْفُرْقَانَ ۝ إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا بِآيَاتِ اللَّهِ لَهُمْ عَذَابٌ شَدِيدٌ ۝ وَاللَّهُ عَزِيزٌ ذُو انْتِقَامٍ ۝

6. Pa dyshim, Allahu është Ai, të cilit nuk i fshihet asgjë në tokë dhe as në qiell.

إِنَّ اللَّهَ لَا يَخْفَىٰ عَلَيْهِ شَيْءٌ فِي الْأَرْضِ وَلَا فِي السَّمَاءِ ۝

7. Është Ai që ju formon në mitra si të dojë. Nuk ka të adhureshëm tjetër përveç Tij, të Plotfuqishmit, të Urtit.

هُوَ الَّذِي يُصَوِّرُكُمْ فِي الْأَرْحَامِ كَيْفَ يَشَاءُ ۝ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ۝

8. Është Ai që të zbriti Librin në të cilin ka ajete të vendosura, që janë ama e Librit, dhe ka të tjera që janë të figurshme. Ata që kanë shtrembëri në zemrat e tyre, i ndjekin të figurshmet,

هُوَ الَّذِي أَنزَلَ عَلَيْكَ الْكِتَابَ مِنْهُ آيَاتٌ مُحْكَمَاتٌ هُنَّ أُمُّ الْكِتَابِ وَأُخَرٌ مُتَشَابِهَاتٌ فَأَمَّا الَّذِينَ فِي قُلُوبِهِمْ زَيْغٌ فَيَتَّبِعُونَ مَا تَشَابَهَ مِنْهُ ابْتِغَاءَ الْفِتْنَةِ

1. Vargjet e Kuranit quhen *ajete*. Ajet do të thotë *shenjë*. Në këtë përkthim, kjo fjalë herë është përkthyer si “shenjë” e herë është lënë në formën origjinale, për t’iu referuar vargjeve të Kuranit ose shpalljeve të Zotit. Çdo varg i Kuranit është shenjë e Allahut, sepse është shpallje e Tij.

duke dashur çrregullimin dhe duke kërkuar interpretimin e tyre. Kurse interpretimin e tyre nuk e di askush, përveç Allahut dhe të thelluarve në dije (që) thonë: “E besuam; gjithçka është prej Zotit tonë”. Askush nuk përfiton nga këshilla, përveç të mençurve.<sup>2</sup>

وَابْتِغَاءَ تَأْوِيلِهِ ۚ وَمَا يَعْلَمُ تَأْوِيلَهُ إِلَّا اللَّهُ ۗ وَالرَّسُخُونَ فِي الْعِلْمِ يَقُولُونَ آمَنَّا بِهِ ۚ كُلٌّ مِّنْ عِنْدِ رَبِّنَا ۚ وَمَا يَذَّكَّرُ إِلَّا أُولُو الْأَلْبَابِ ۝

9. O Zoti ynë! Mos na shtrembëro zemrat tona, pasi na ke udhëzuar dhe na dhuro mëshirë prej Teje! Me të vërtetë, Ti je Dhuruesi i madh.

رَبَّنَا لَا تُزِغْ قُلُوبَنَا بَعْدَ إِذْ هَدَيْتَنَا وَهَبْ لَنَا مِن لَّدُنكَ رَحْمَةً ۚ إِنَّكَ أَنْتَ الْوَهَّابُ ۝

10. O Zoti ynë! Ti je Mbledhësi i njerëzve për ditën, në të cilën nuk ka dyshim. Sigurisht, Allahu nuk e shkel premtimin.

رَبَّنَا إِنَّكَ جَامِعُ النَّاسِ لِيَوْمٍ لَا رَيْبَ فِيهِ ۚ إِنَّ اللَّهَ لَا يُخْلِفُ الْمِيعَادَ ۝

11. Ata që mohuan, nuk do t'u vlejné aspak pasuritë dhe fëmijët e tyre kundër Allahut. Pikërisht ata do të jenë lëndë djegëse e zjarrit.

إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا لَنْ تُعْنِيَ عَنْهُمْ أَمْوَالُهُمْ وَلَا أَوْلَادُهُمْ مِنَ اللَّهِ شَيْئًا ۚ وَأُولَئِكَ هُمْ وَقُودُ النَّارِ ۝

2. Disa nga ajetet e Kuranit janë të vendosura (*muhkemat*) në kuptimin që janë të qarta dhe nuk kanë vend për keqkuptime. Por ka disa ajete që janë të figurshme (*muteshabihat*), ku një lexues mund të gabojë në interpretimin e tyre. Por lexuesi i tillë kur u referohet ajeteve të vendosura, do ta kuptojë gabimin. Në këtë mënyrë, ajetet e vendosura janë quajtur gjithashtu nëna ose baza e Librit. Ajetet e vendosura në përgjithësi trajtojnë ligjin dhe doktrinat e besimit, ndërsa të figurshmet trajtojnë në përgjithësi elemente dytësore të ligjeve, ose përshkruajnë incidente të jetës së Profetëve apo të popujve të ndryshëm në atë mënyrë që ato të shërbejnë edhe si profeci për të ardhmen dhe, si të tilla, shpesh ato kanë edhe idioma dhe gjuhë konotative. Ata që kanë shtrembëri në zemrat, kur i lexojnë historitë e përmendura nga Kurani e që janë përmendur edhe në Librat e mëparshëm, tentojnë t'i kuptojnë duke u bazuar nga ajo që është mitizuar në të kaluarën, duke i harruar ajetet e vendosura të Kuranit, dhe në këtë mënyrë e fshehin meritën e Kuranit, i cili ka treguar të vërtetën e atyre historive. Andaj, ajetet e tilla, pra të figurshmet, nuk duhet t'i interpretoni në atë mënyrë që ato të bien ndesh me ajetet e vendosura. Duhet thënë se prania e gjuhës konotative, ose e metaforave, në ajetet e figurshme duket si në Kuranin e Shenjtë, ashtu edhe në Librat e mëparshëm Hyjnorë. Gjuha e figurshme është domosdoshmëri për të siguruar shumëkuptimësinë me sa më pak fjalë, për t'i shtuar bukurinë dhe elokuencën ligjërimit dhe gjithashtu, siç pohohet edhe në këtë ajet, për t'i vënë në provë njerëzit si nevojë e zhvillimit dhe e përsosjes së tyre shpirtërore. Lexoni edhe 56:80.

12. Ashtu si populli i Faraonit dhe si ata që ishin para tyre, i quajtën gënjeshtër shenjat Tona, atëherë Allahu i kapi për shkak të mëkateve të tyre. Allahu është i rreptë në ndëshkim.

13. Thuaju atyre që mohuan: “Njëmend, do të mposhteni e do të tuboheni në xhehenem. Eh sa shtrat i keq është ai!”

14. Keni një shenjë në dy grupet që u ndeshën. Njëri grup që luftonte në rrugën e Allahut dhe tjetri që qe mohues. (Këta të fundit) i shikonin (besimtarët) të dyfishtë me sy. Allahu mbështet me ndihmën e Tij kë të dojë. Në të ka mësim për ata që janë largpamës.

15. Njerëzve u është treguar joshëse dashuria ndaj gjërave të dëshiruara, pra, ndaj grave, fëmijëve, thesareve të bollshme ari dhe argjendi, kuajve të piketuar, bagëtive dhe arave. Këto janë një mjet i përkohshëm i jetës së kësaj bote. Kurse Allahu është Ai që ka vendkthimin më të mbarë.

16. Thuaj: A t’ju tregoj për diçka më të mirë sesa këto? Për ata që do të përvetësojnë druajtjen (ndaj Zotit), ka kopshte te Zoti i tyre, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Në to do të jetojnë përgjithmonë. Dhe ka edhe bashkëshortë të dëlirë dhe pëlqimi prej Allahut. Allahu i sheh mirë robërit.

كَذَابِ آلِ فِرْعَوْنَ ۗ وَالَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ ۗ  
كَذَّبُوا بِآيَاتِنَا ۖ فَأَخَذَهُمُ اللَّهُ بِذُنُوبِهِمْ ۗ  
وَاللَّهُ شَدِيدُ الْعِقَابِ ۝

قُلْ لِلَّذِينَ كَفَرُوا سَعْلَبُونَ ۖ وَنُحُشِرُونَ  
إِلَىٰ جَهَنَّمَ ۗ وَبَسَّ الْمُهَادِ ۝

قَدْ كَانَ لَكُمْ آيَةٌ فِي فِتْنَةِ الْمُتَقَاتِ ۗ فِتْنَةٌ  
تُقَاتِلُ فِي سَبِيلِ اللَّهِ وَأُخْرَىٰ كَافِرَةٌ  
يَرَوْنَهَا مِثْلَيْهَا رَأَى الْعَيْنُ ۗ وَاللَّهُ  
يُؤَيِّدُ بِنَصْرِهِ مَنْ يَشَاءُ ۗ إِنَّ فِي ذَٰلِكَ  
لَعِبْرَةً لِّأُولِي الْأَبْصَارِ ۝

رُزِقَ لِلنَّاسِ حُبُّ الشَّهَوَاتِ مِنَ النِّسَاءِ  
وَالْبَنِينَ وَالْقَنَاطِيرِ الْمُقَنْطَرَةِ مِنَ الذَّهَبِ  
وَالْفِضَّةِ وَالْخَيْلِ الْمُسَوَّمَةِ وَ الْأَنْعَامِ  
وَالْأَحْرَابِ ۗ ذَٰلِكَ مَتَاعُ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا  
وَاللَّهُ عِنْدَهُ حَسَنُ الْمَآبِ ۝

قُلْ أَوْبَيْنَاكُمْ بِخَيْرٍ ۗ مِنْ ذِكْمِ ۗ لِلَّذِينَ  
اتَّقَوْا عِنْدَ رَبِّهِمْ جَنَّاتٌ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا  
الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا وَ أَرْوَاحٌ مُطَهَّرَةٌ  
وَرِضْوَانٌ مِّنَ اللَّهِ ۗ وَاللَّهُ بَصِيرٌ بِالْعِبَادِ ۝

17. (Këto janë për ata) që thonë: “O Zoti ynë! Ne pa dyshim që besuam. Andaj, na fal gjynahet dhe na shpëto prej ndëshkimit të zjarrit!”

الَّذِينَ يَقُولُونَ رَبَّنَا إِنَّنَا أَمْنَا فَأَغْفِرْنَا  
ذُنُوبَنَا وَتَنَا عَذَابَ النَّارِ ﴿١٧﴾

18. (Që janë) të duruar, të vërtetë, të nënshtruar, që shpenzojnë dhe që kërkojnë falje gjatë agimeve.<sup>3</sup>

الصَّابِرِينَ وَالصَّادِقِينَ وَالْقَانِتِينَ وَالْمُنْتَقِبِينَ  
وَالْمُسْتَغْفِرِينَ بِالْأَسْحَارِ ﴿١٨﴾

19. Allahu, i vendosur në drejtësi, dëshmon se me të vërtetë nuk ka të adhurueshëm tjetër përveç Atij, edhe engjëjt dhe të diturit (dëshmojnë) po ashtu. Nuk ka të adhurueshëm tjetër përveç Atij, të Plotfuqishmit, të Urtit.

شَهِدَ اللَّهُ أَنَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ ۖ وَالْمَلَائِكَةُ  
وَأُولُو الْعِلْمِ قَائِمًا بِالْقِسْطِ ۗ لَا إِلَهَ إِلَّا  
هُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ﴿١٩﴾

20. Sigurisht, feja tek Allahu është Islami.<sup>4</sup> Ata të cilëve u është dhënë

إِنَّ الدِّينَ عِنْدَ اللَّهِ الْإِسْلَامُ ۗ وَمَا  
اخْتَلَفَ الَّذِينَ أُوْتُوا الْكِتَابَ إِلَّا مِنْ

3. Shenjat e veçanta të një besimtari të vërtetë të përmendura në këtë ajet në fakt janë katër faza të përparimit shpirtëror: (1) Kur një njeri përqafton besimin e vërtetë, përgjithësisht përballet me përqeshjen, kundërshtimin dhe diku edhe me persekutimin; prandaj, ajo që i duhet më së shumti në fazën e parë është durimi ose qëndrueshmëria. (2) Kur kundërshtimi merr fund dhe besimtari është i lirë të veprojë sipas besimit të tij, ai zbaton në praktikë mësimet, të cilat nuk ishte në gjendje t'i zbatonte plotësisht më parë. Në këtë fazë, atij i duhet të qëmtojë mësimet e Zotit për çështjet ku ndihet i dobët, dhe t'i zbatojë edhe ato, në mënyrë që jeta e tij të fitojë vërtetësinë; pra çdo fjalë dhe çdo vepër e tij të bazohet në të vërtetën dhe jo në bindje të dikujt tjetër. (3) Si rezultat i fazës paraardhëse, besimtari fiton fuqinë, andaj, në këtë fazë i duhet përlësia. Duke qenë i vetëdijshëm për dobësinë e tij dhe për mëshirën e Zotit, ai bëhet akoma më shumë i përlulur, dhe nuk mburret për bindjen dhe fuqinë që ka. (4) Për këtë arsye, ndjenjat e tij për t'iu shërbyer të tjerëve pa dallim fuqizohen dhe ai shpenzon për ta nga çdo gjë që Allahu i ka dhuruar. Por, siç theksojnë fjalët përmbyllëse të ajetit, gjatë gjithë këtij rrugëtimi, ai vazhdimisht bën *istigfar*, d.m.th. i kërkon fuqi Allahut, sidomos në agim, pra, përpara se të fillojë ditën. Për kuptimin e *istigfarit*, lexoni 48:3.

4. *Islam* do të thotë *nënshtrim, siguri, paqe*. Islami në thelb, siç e paraqet Kurani, nuk është një fe e re. Madje, pikërisht këtë fe e sollën prej Zotit të gjithë Profetët e mëparshëm. Kështu që, të gjitha fetë fillimisht i dhanë botës mësimin e Njëshmërisë së Zotit dhe të ndjekjes së rrugës së drejtë. Megjithatë, Kurani i Shenjtë për dy arsye ka epërsi mbi mësimet e mëparshme: (1) Profetët e mëparshëm nuk ishin për të gjithë botën, por për pjesë të caktuara të botës, andaj edhe mësimet e tyre mbulonin vetëm çështjet e përkohshme dhe përputheshin vetëm me aftësitë e njerëzve të vendeve përkatëse. (2) Mësimet që sillnin Profetët e mëparshëm, paqja qoftë mbi ta, nuk ishin për të gjitha kohërat, por për kohë të caktuara, në të cilat ato kanë kryer funksionin e tyre të të udhëzuarit, prandaj edhe Zoti i Madhërisëm nuk deshi që



Libri ranë në kundërshti vetëm pasi u erdhi dija, duke u rebeluar ndaj njëri-tjetrit. Ai që mohon shenjat e Allahut, (le ta dijë se) Allahu është i shpejtë në llogari.

21. Prandaj, nëse ata grinden me ty, thuaju: I kam nënshtruar tërësisht vëmendjen time Allahut dhe, edhe ndjekësit e mi po ashtu. Dhe thuaju atyre që u është dhënë Libri si dhe atyre që janë të paditur: “A keni pranuar Islamin?” Po e pranuan Islamin, pa dyshim që e gjetën udhëzimin dhe, po ta kthyen shpinën, atëherë ti ke për detyrë vetëm që t’ua kumtosh. Allahu i sheh mirë robërit.

22. Atyre që mohojnë shenjat Tona, që pa të drejtë i luftojnë<sup>5</sup> Profetët dhe i luftojnë edhe ata që porosisin për drejtësinë, jepu lajmin e ndëshkimit të dhimbshëm.

23. Pikërisht ata janë të cilëve u ranë poshtë veprat e tyre në këtë botë dhe në *ahiret*. Ata nuk do të kenë ndihmëtarë.

24. A nuk i ke parë ata, të cilëve u ishte dhënë një pjesë nga Libri, të cilëve u bëhet thirrje për Librin

بَعْدَ مَا جَاءَهُمُ الْعِلْمُ بَعِيًّا بَيْنَهُمْ ۗ وَمَنْ يَكْفُرْ بِآيَاتِ اللَّهِ فَإِنَّ اللَّهَ سَرِيعُ الْحِسَابِ ﴿١١﴾

فَإِنْ حَاجُّوكَ فَقُلْ أَسَلَمْتُ وَجْهِيَ لِلَّهِ  
وَمَنِ اتَّبَعَنِ ۗ وَقُلْ لِلَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ  
وَالْأُمِّيِّينَ ءَ أَسَلَمْتُ ۗ فَإِنْ أَسَلَمُوا فَقَدْ  
اهْتَدَوْا ۗ وَإِنْ تَوَلَّوْا فَإِنَّمَا عَلَيْكَ الْبَلَاغُ  
بِاللَّهِ بِصِيرٍ بِأَعْبَادٍ ﴿١٢﴾

إِنَّ الَّذِينَ يَكْفُرُونَ بِآيَاتِ اللَّهِ وَيَقْتُلُونَ  
النَّبِيَّ بَعِيرٍ حَقِّ ۗ وَيَقْتُلُونَ الَّذِينَ يَأْمُرُونَ  
بِالْقِسْطِ مِنَ النَّاسِ ۗ فَبِئْسَ لَهُمْ بَعْدَ  
الْبَلَاءِ ﴿١٣﴾

أُولَئِكَ الَّذِينَ حَبِطَتْ أَعْمَالُهُمْ فِي الدُّنْيَا  
وَالْآخِرَةِ ۗ وَمَا لَهُمْ مِنْ نَاصِرِينَ ﴿١٤﴾

أَلَمْ تَرَ إِلَى الَّذِينَ أُوتُوا نَصِيًّا مِّنَ  
الْكِتَابِ يُدْعَوْنَ إِلَى كِتَابِ اللَّهِ لِيَحْكَمَ

udhëzimet e tyre të ruheshin deri në fund të botës. Kurse Kurani i Shenjtë është për të gjithë botën, dhe për të gjitha kohërat, andaj, vetë Zoti e ka quajtur fenë *Islam* në këtë Libër (5:4; 22:79) dhe po Ai ka marrë përsipër mbrojtjen e këtij Libri, edhe ruajtjen tekstuale, edhe atë kuptimore të tij. (15:10).

5. Një ndër kuptimet e fjalës *katele*: kundërshtim i ashpër, bojkot. (Lisan el-Arab). Lexoni edhe 3:113.

e Allahut që të gjykojnë ndërmjet tyre, por një grup prej tyre kthejnë shpinën?! E shpërfillin.

25. Kjo është gjendja sepse ata thanë: “Nuk do të na prekë zjarri, përveçse vetëm për ca ditë të numëruara”. Shpifjet e tyre i mashtruan vetë ata në lidhje me besimin e tyre.

26. Çfarë do të ndodhë kur do t'i mbledhim ata për një ditë, në të cilën nuk ka dyshim, dhe çdo shpirti do t'i jepet haku i plotë i asaj që ka punuar dhe atij nuk do t'i bëhet padrejtësi aspak?!

27. Thuaj: O Allah! Zotërues i sundimit! Ti ia jep sundimin kujt të duash dhe ia merr sundimin kujt të duash. Ti nderon kë të duash dhe poshtëron kë të duash. Në dorën Tënde është mirësia. Ti pa dyshim je i Plotfuqishëm për çdo gjë.

28. Ti e fut natën në ditë dhe e fut ditën në natë. Ti nxjerr të gjallin nga i vdekuri dhe nxjerr të vdekurin nga i gjalli. Ti i jep pa masë kujt të duash.

29. Besimtarët të mos bëjnë shokë mohuesit në vend të besimtarëve. Ai që bën një gjë të tillë, nuk ka asnjë lidhje me Allahun, vetëm nëse ruheni me kujdes prej tyre. Allahu ju paralajmëron nga Vetja e Tij. Tek Allahu është kthimi.<sup>6</sup>

بَيْنَهُمْ ثُمَّ يَوْمَ قَرِيْقٍ مِّنْهُمْ وَهُمْ مُّعْرِضُونَ ﴿١٤﴾

ذٰلِكَ بِاَنَّهُمْ قَالُوْا لَنْ تَمَسَّنَا النَّارُ اِلاَّ اَيَّامًا مَّعْدُوْدٰتٍ ۗ وَغَرَّهُمْ فِى دِيْنِهِمْ مَا كَانُوْا يَفْتَرُوْنَ ﴿١٥﴾

فَكَيْفَ اِذَا جَمَعْنَاهُمْ لِيَوْمٍ لَا رَيْبَ فِيْهِ ۗ وَوَقَّيْتُ كُلَّ نَفْسٍ مَّا كَسَبَتْ وَهُمْ لَا يُظْلَمُوْنَ ﴿١٦﴾

قُلِ اللّٰهُمَّ مٰلِكَ الْمُلْكِ تُؤْتِي الْمُلْكَ مَنْ تَشَاءُ وَتَنْزِعُ الْمُلْكَ مِمَّنْ تَشَاءُ ۗ وَتُعْزِزُ مَنْ تَشَاءُ وَتُذَلِّقُ مَنْ تَشَاءُ ۗ بِيَدِكَ الْخَيْرُ ۗ اِنَّكَ عَلٰى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيْرٌ ﴿١٧﴾

تَوَلِّجَ الْاَيْلَ فِى النَّهَارِ وَتَوَلِّجَ النَّهَارَ فِى الْاَيْلِ ۗ وَتُخْرِجُ الْحَيَّ مِنَ الْمَيِّتِ وَتُخْرِجُ الْمَيِّتَ مِنَ الْحَيِّ ۗ وَتَرْزُقُ مَنْ تَشَاءُ بِغَيْرِ حِسَابٍ ﴿١٨﴾

لَا يَتَّخِذِ الْمُؤْمِنُوْنَ الْكٰفِرِيْنَ اَوْلِيَآءَ مِنْ دُوْنِ الْمُؤْمِنِيْنَ ۗ وَمَنْ يَّفْعَلْ ذٰلِكَ فَلَيْسَ مِنَ اللّٰهِ فِى شَيْءٍ ۗ اِلَّا اَنْ تَتَّقُوْا مِنْهُمْ تُقٰةً ۗ وَيُحَذِّرُكُمُ اللّٰهُ نَفْسَهُ ۗ وَالِىَّ اللّٰهُ الْمَصِيْرُ ﴿١٩﴾

6. Lexoni 60:9-10 dhe 3:119-121.

30. Thuaj: Daç e fshihni atë që keni në kraharorët tuaj, daç e zbuloni, Allahu e di atë. Ai e di atë çfarë ka në qiej dhe atë çfarë ka në tokë dhe Allahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë.

قُلْ إِنْ تُخْفُوا مَا فِي صُدُورِكُمْ أَوْ تُبْدُوهُ  
يَعْلَمُهُ اللَّهُ وَيَعْلَمَ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا  
فِي الْأَرْضِ وَاللَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿٣٠﴾

31. Ditën kur çdo shpirt do ta gjejë përpara çdo mirësi që ka bërë, dhe (për) çdo të keqe që ka bërë, do të dëshirojë sikur të ishte largësi e madhe midis tij dhe asaj. Allahu ju paralajmëron nga Vetja e Tij. Por Allahu është shumë i Dhembshur ndaj robërve.

يَوْمَ تَجِدُ كُلُّ نَفْسٍ مَّا عَمِلَتْ مِنْ خَيْرٍ  
مُحْضَرًا ۗ وَمَا عَمِلَتْ مِنْ سُوءٍ ۖ تَوَدُّ لَوْ  
أَنَّ بَيْنَهَا وَبَيْنَهُ أَمَدًا بَعِيدًا ۗ وَيُحَذِّرُكُمُ  
اللَّهُ نَفْسَهُ ۗ وَاللَّهُ رَءُوفٌ بِالْعِبَادِ ﴿٣١﴾

32. Thuaj: Nëse e doni Allahun, më ndiqni mua, Allahu do t'ju dojë dhe do t'ju falë gjynahet tuaja. Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.<sup>7</sup>

قُلْ إِنْ كُنْتُمْ تُحِبُّونَ اللَّهَ فَاتَّبِعُونِي  
يُحِبُّكُمُ اللَّهُ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ ۗ وَاللَّهُ  
غَفُورٌ رَحِيمٌ ﴿٣٢﴾

33. Thuaj: “Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit”. E nëse ata do të (të) kthejnë shpinën, atëherë Allahu përnjëmend nuk i do mohuesit.

قُلْ أَطِيعُوا اللَّهَ وَارْتَابِعُوا الرَّسُولَ ۚ فَإِنْ تَوَلَّوْا  
فَإِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ الْكٰفِرِينَ ﴿٣٣﴾

7. Cila është ajo dritë, e cila përmes ndjekjes së Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, t'i largon mëkatet? Ajo është një njohje e pastër që nuk ka asnjë grimë errësire a dyshimi; dashuri e pastër dhe tërësisht vetëmohuese; kënaqësi e pastër, më e madhe se çdo kënaqësi tjetër; tërheqje e fuqishme të cilën nuk e mposht dot asnjë tërheqje tjetër; ilaç shumë ndikues që t'i largon të gjitha helmet shpirtërore. Këto janë pesë elemente që si një dritë dhe në formën e Shpirtit të shenjtë zbresin në zemrën e ndjekësit. Andaj, zemra e një njeriu të tillë jo vetëm që i shmanget mëkatit, madje fillon ta urrejë atë në mënyrë të natyrshme. Diku tjetër në Kuran Zoti na porositi të ndjekim edhe modelin e Hazret Ibrahim<sup>as</sup>, por aty ka lënë edhe një përjashtim për një aspekt të jetës së tij (60:5), por për jetën e Profetit<sup>savs</sup> nuk ka përmendur asnjë përjashtim të tillë. Edhe kjo tregon se fjalët dhe veprat e Profetit<sup>savs</sup> janë tërësisht të pastra nga gabimi. Ndjekja e Profetit<sup>savs</sup> të siguron dashurinë e Allahut. Ai që ka dashuri për dikë, patjetër që edhe i flet. Andaj, kur Zoti fillon ta dojë robin për shkak të ndjekjes së tij ndaj Profetit<sup>savs</sup>, Zoti edhe komunikon me të, i zbulon të padukshmen. Kjo kur bëhet me shumicë, quhet profetëri.

34. Pa dyshim, Allahu ka zgjedhur Ademin, Nuhun, familjen e Ibrahimit dhe familjen e Imranit mbi botët.

إِنَّ اللَّهَ اصْطَفَىٰ آدَمَ وَنُوحًا وَآلَ إِبْرَاهِيمَ  
وَآلَ عِمْرَانَ عَلَى الْعَالَمِينَ ﴿٢٩﴾

35. Disa prej tyre janë pasardhës të disave të tjerë. Allahu është Gjithëdëgjues, i Gjithëdijshëm.

ذُرِّيَّةً بَعْضُهَا مِنْ بَعْضٍ ۗ وَاللَّهُ سَمِيعٌ  
عَلِيمٌ ﴿٣٠﴾

36. Kur një grua e Imranit tha: “O Zoti im! Ty ta kam kushtuar atë që kam në bark, duke e liruar atë (nga çështjet e botës). Pranoje prej meje! Ti me të vërtetë je Gjithëdëgjuesi, i Gjithëdijshmi.”

إِذ قَالَتِ امْرَأَتُ عِمْرَانَ رَبِّ إِنِّي نَذَرْتُ  
لَكَ مَا فِي بَطْنِي مُحَرَّرًا فَتَقَبَّلْ مِنِّي ۗ  
إِنَّكَ أَنْتَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ ﴿٣١﴾

37. E kur e lindi, tha: “O Zoti im! E paskam lindur femër,” – Kurse Allahu e di më mirë se çfarë ka lindur ajo dhe se mashkulli nuk është si femra, – “e unë ia vura emrin Merjeme, dhe për të dhe për pasardhësit e saj kërkoj mbrojtjen Tënde nga djalli i mallkuar!”

فَلَمَّا وَضَعَتْهَا قَالَتْ رَبِّ إِنِّي وَضَعْتُهَا  
أُنْثَىٰ ۗ وَاللَّهُ أَعْلَمُ بِمَا وَضَعْتَ ۗ وَلَيْسَ  
الذَّكَرُ كَالْأُنْثَىٰ ۗ وَإِنِّي سَمَّيْتُهَا مَرْيَمَ  
وَإِنِّي أُعِيذُهَا بِكَ وَذَرِّيَّتَهَا مِنَ الشَّيْطَانِ  
الرَّجِيمِ ﴿٣٢﴾

38. Prandaj, Zoti i saj ia pranoi në mënyrën më të bukur, e rriti në mënyrën më të mirë dhe ia la Zekerijasë të kujdesej për të. Sa herë që Zekerija hynte në dhomën e saj të adhurimit, gjente ushqim pranë saj. Ai tha: “O Merjeme! Nga të vjen kjo?” Ajo tha: “Është prej Allahut; Allahu ia jep kujt të dojë pa masë.”

فَتَقَبَّلَهَا رَبُّهَا بِقَبُولٍ حَسَنٍ وَأَنْبَتَهَا نَبَاتًا  
حَسَنًا ۗ وَكَفَّلَهَا زَكَرِيَّا ۗ كُلَّمَا دَخَلَ عَلَيْهَا  
زَكَرِيَّا الْمِحْرَابَ ۗ وَجَدَ عِنْدَهَا رِزْقًا ۗ قَالَ  
يُرِيْمُ أَتَىٰ لِكَ هَذَا ۗ قَالَتْ هُوَ مِنْ عِنْدِ  
اللَّهِ ۗ إِنَّ اللَّهَ يَرْزُقُ مَنْ يَشَاءُ بِغَيْرِ  
حِسَابٍ ﴿٣٣﴾

39. Atëherë, Zekerija iu lut Zotit të tij. Tha: “O Zoti im, më dhuro prej Vetes një pasardhës të dëlirë. Ti pa dyshim e dëgjon shumë lutjen!”

هَذَا لِكَ دَعَا زَكَرِيَّا رَبَّهُ ۗ قَالَ رَبِّ هَبْ لِي  
مِنْ لَدُنْكَ ذُرِّيَّةً طَيِّبَةً ۗ إِنَّكَ سَمِيعُ  
الدُّعَاءِ ﴿٣٤﴾

40. Endërsa po adhuronte në këmbë, në dhomën e adhurimit, engjëjt e thirrën: “Allahu të jep sihariqin e Jahjait, që do të jetë vërtetues i një fjale të Allahut dhe do të jetë prijës, i dëlirë dhe Profet prej të mirëve.”<sup>8</sup>

41. Ai tha: “O Zoti im! Si mund të kem unë djalë tani që më ka zënë pleqëria dhe gruaja ime është shterpë?” Ai tha: “Ashtu është, (por) Allahu e bën atë që do.”

42. Ai tha: “O Zot im, më cakto ndonjë shenjë.” Ai tha: “Shenja për ty është që të mos komunikosh me njerëzit për tri ditë, përveçse me gjeste. Po ashtu, kujtoje Zotin shumë dhe madhëroje (Atë) në mbrëmje e në mëngjes.”<sup>9</sup>

43. Dhe kur engjëjt i thanë: “O Merjeme! Allahu të ka zgjedhur, të ka dëlirësuar dhe të ka zgjedhur mbi gratë e botëve.

44. O Merjeme! Bindju Zotit tënd, bëj sexhde dhe përkulu me ata që përkulen (për Të).”

فَدَاتَهُ الْمَلَكَةُ وَهُوَ قَائِمٌ يُصَلِّي فِي  
الْمِحْرَابِ ۗ إِنَّ اللَّهَ يَبْشُرُ بِبِحْيِ  
مُصَدِّقًا بِكَلِمَةٍ مِّنَ اللَّهِ وَسَيِّدًا وَحَصُورًا  
وَنَبِيًّا مِّنَ الصَّالِحِينَ ﴿٤٠﴾

قَالَ رَبِّ أَلَىٰ يَكُونُ لِي عُلْمٌ ۖ وَقَدْ بَلَغَنِي  
الْكِبَرُ وَامْرَأَتِي عَاقِرٌ ۗ قَالَ كَذَلِكَ اللَّهُ  
يَفْعَلُ مَا يَشَاءُ ﴿٤١﴾

قَالَ رَبِّ اجْعَلْ لِي آيَةً ۗ قَالَ آيَتُكَ أَلَّا  
تُكَلِّمَ النَّاسَ ثَلَاثَةَ أَيَّامٍ ۖ إِلَّا رَمْرًا  
وَأَذْكُرَ رَبِّكَ كَثِيرًا ۖ وَسَبِّحَ بِالْعَشِيِّ  
وَإِلْبَارِئِ ﴿٤٢﴾

وَإِذْ قَالَتِ الْمَلِكَةُ مَرْيَمُ إِنَّ اللَّهَ  
اصْطَفَاكِ وَطَهَّرَكِ وَاصْطَفَاكِ عَلَىٰ نِسَاءِ  
الْعَالَمِينَ ﴿٤٣﴾

مَرْيَمُ اقْنُتِي لِرَبِّكِ وَاسْجُدِي وَارْكَعِي  
مَعَ الرَّاكِعِينَ ﴿٤٤﴾

8. Në Bibël thuhet se Jahja (Gjoni)<sup>as</sup> erdhi si përbushje e profecisë së Profetit Malakia, ku nëpërmjet tij Zoti tha: “Ja, unë do t’ju dërgoj Elian, profetin, para se të vijë dita e madhe dhe e lahtarshme e Zotit.” (Bibla, Malakia 4:5). Kur hebrenjtë e pyetën Isain (Jezusin)<sup>as</sup> se përse Elia nuk kishte ardhur ende, ai iu përgjigj: “Sepse të gjithë profetët dhe ligji kanë profetizuar deri te Gjoni. Dhe, në daç ta pranoni, ai është Elia, që duhej të vijë. Kush ka veshë për të dëgjuar, le të dëgjojë!” (Bibla, Mateu 11:13-15).

9. Disa komentues pohojnë se shenja që Allahu i dha Hazret Zekerijas<sup>as</sup> që nuk duhet të fliste për tri ditë përveçse me gjeste, gjoja sikur i ishte shfaqur ndonjë sëmundje e tillë që nuk e lejonte të fliste. Por fjalët e Kuranit nuk lejojnë një interpretim të tillë, pasi nuk thonë askund “nuk mund të flasësh...”. Realisht, këtu fjala shenjë është në kuptimin e porosisë. Pra, Allahu e porositi të mos komunikonte me të tjerët përveçse me gjeste.

45. Këto janë lajme nga e padukshmja, që Ne t'i diktuam ty. Ti nuk ishe pranë tyre, kur ata po hidhnin short se kush do të kujdesej për Merjemen. Dhe ti nuk ishe pranë tyre kur ata po debatonin (për këtë çështje).

ذٰلِكَ مِنْ اَنْبَاءِ الْغَيْبِ نُوحِيهِ اِلَيْكَ  
وَمَا كُنْتَ لَدَيْهِمْ اِذْ يُلْقُونَ اَقْلَامَهُمْ  
اِيَّهِمْ يَكْفُلْ مَرِيَمَ ۚ وَمَا كُنْتَ لَدَيْهِمْ  
اِذْ يَخْتَصِمُونَ ﴿٤٥﴾

46. Kur engjëjt i thanë: “O Merjeme! Allahu të jep lajmin e mirë të një fjale<sup>10</sup> prej Tij, quhet Mesih Isai, biri i Merjemes, që do të jetë i shquar në këtë botë dhe në *ahiret*, dhe do të jetë një prej të afërmeve.

اِذْ قَالَتِ الْمَلٰٓئِكَةُ مَرِيَمُ اِنَّ اللّٰهَ يَبَشِّرُكَ  
بِكَلِمَةٍ مِنْهُ ۗ اَسْمُهُ الْمَسِيْحُ عِيسٰى ابْنُ  
مَرِيَمَ وَجِيهًا فِي الدُّنْيَا وَالْاٰخِرَةِ وَمِنْ  
الْمُقَرَّبِيْنَ ﴿٤٦﴾

47. Ai do të flasë me njerëzit që në djep e në parapleqëri dhe do të jetë një prej të mirëve.

وَيَكَلِّمُ النَّاسَ فِي الْمَهْدِ وَكَهْلًا ۗ وَمِنْ  
الصّٰلِحِيْنَ ﴿٤٧﴾

48. Ajo tha: “O Zoti im! Si mund të kem unë djalë, kur nuk më ka prekur njeri?!” Ai tha: “Ashtu është, (por) Allahu krijon çfarë të dojë. Kur Ai vendos diçka, për të vetëm thotë “Bëhu!”, dhe ajo bëhet.<sup>11</sup>

قَالَتْ رَبِّ اِنِّيْ يَكُوْنُ لِيْ وَكَدَّ وَاَلَمْ  
يَمْسَسْنِيْ بَشْرًا ۗ قَالَ كَذٰلِكَ اللّٰهُ يَخْلُقُ  
مَا يَشَاءُ ۗ اِذَا قَضٰى اَمْرًا فَاِنَّمَا يَقُوْلُ  
لَهٗ كُنْ فَيَكُوْنُ ﴿٤٨﴾

10. Këtu “fjalë” nënkupton vendimin e Allahut kur thotë “Bëhu!”. Por, të krishterët e interpretojnë këtë ajet duke thënë se vetëm Mesihu ka qenë fjala e Zotit dhe të gjithë Profetët e tjerë, në pozitë, kanë qenë më poshtë. Ata citojnë Biblën, ku thuhet: “Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte pranë Perëndisë, dhe Fjala ishte Perëndi” (Gjoni 1:1). Kurani i Shenjtë fuqimisht e hedh poshtë këtë ide në ajetet e fundit të sures El-Kehf, në të cilat thotë se Zoti ka kaq shumë fjalë, sa që edhe sikur të gjitha detet të bëhen bojë shkrimi dhe të sillen po aq dete të tjera, ato nuk mund të përfundojnë (18:110; 31:28). Kështu që, duke e keqinterpretuar fjalën “fjalë”, të krishterët i japin Mesihut cilësi mbinjerëzore.

11. *Hazret Isai*<sup>as</sup> lindi pa baba dhe kjo ishte një shenjë për bijtë e Izraelit që në fisin e tyre po sosej fara e profetërisë, pasi premtimi i Zotit për profetërinë të ta ishte i kushtëzuar me druajtjen dhe pastërtinë e tyre shpirtërore (2:125). Kur ata nuk patën më druajtje ndaj Zotit, Zoti ua dha këtë shenjë, që i mençuri ta kuptonte se profetërisë së tyre po i vinte fundi. Përmendja e lindjes së *Hazret Isait*<sup>as</sup> bashkë me përmendjen e lindjes së *Hazret Jahjait*<sup>as</sup> ndër të tjera tregon se ashtu siç lindja e Jahjait ishte në kushte të jashtëzakonshme, në të njëjtën mënyrë edhe lindja e Isait u bë në kushte të ngjashme. Pra, Zoti tregoi fuqinë e Tij se Ai mund ta krijonte Jahjain përmes mrekullisë së Tij kur të dy prindërit nuk kishin asnjë mundësi për

49. Ai do t'i mësojë Librin, urtësinë, Teuratin dhe Inxhilin.

50. Dhe do të jetë i Dërguar për bijtë e Izraelit,<sup>12</sup> (të cilëve do t'u thotë): 'Kam ardhur tek ju me një shenjë prej Zotit tuaj, që, krijoj për ju nga balta një formë shpendi e më pas fryj në të dhe ajo, me urdhrin e Allahut, bëhet shpend; shëroj të verbrin e lindur dhe të lebrosurin dhe ngjall të vdekurin me urdhrin e Allahut; ju tregoj se çfarë hani e çfarë rezervoni nëpër shtëpitë tuaja. Sigurisht, në të keni një shenjë, nëse jeni besimtarë.<sup>13</sup>

51. Gjithashtu, (kam ardhur tek ju) si vërtetues i asaj që kam përpara nga Teurati dhe që t'ju lejoj disa gjëra që ishin të ndaluara për ju. Përnjëmend, kam ardhur tek ju me një shenjë prej

وَيُعَلِّمُهُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَالتَّوْرَةَ  
وَالْإِنْجِيلَ ۗ

وَرَسُولًا إِلَىٰ بَنِي إِسْرَائِيلَ ۚ أَنِّي قَدْ  
جِئْتُكُمْ بِآيَةٍ مِّن رَّبِّكُمْ ۚ إِنِّي أَخْلُقُ لَكُمْ  
مِّنَ الطَّيْرِ كَهَيْئَةِ الطَّيْرِ فَأَنْفُخُ فِيهِ  
فَيَكُونُ طَيْرًا بِإِذْنِ اللَّهِ ۗ وَأُبْرِئُ  
الْأَكْمَةَ وَالْأَبْرَصَ وَأُحْيِي الْمَوْتَىٰ بِإِذْنِ  
اللَّهِ ۗ وَأُنَبِّئُكُمْ بِمَا تَأْكُلُونَ وَمَا تَدَّخِرُونَ  
فِي بُيُوتِكُمْ ۗ إِنَّ فِي ذَٰلِكَ لَآيَةً لِّكُمْ إِن  
كُنْتُمْ مُّؤْمِنِينَ ۗ

وَمُصَدِّقًا لِّمَا بَيْنَ يَدَيْ مِنَ التَّوْرَةِ  
وَلِأَحَلِّ لَكُمْ بَعْضَ الَّذِي حُرِّمَ عَلَيْكُمْ  
وَجِئْتُكُمْ بِآيَةٍ مِّن رَّبِّكُمْ ۗ فَاتَّقُوا اللَّهَ

të lindur fëmijë, dhe jo vetëm kaq, Ai është Fuqiplotë ta krijojë edhe Isain pa baba.

12. Fjalët e Kuranit “i Dërguar për bijtë e Izraelit” tregojnë se misioni i Hazret Isait<sup>as</sup> ishte i kufizuar vetëm deri te bijtë e Izraelit dhe jo për të gjithë botën. (Bibla, Mateu 10:5-6; 15:24; 19:28; Luka 22:28-31).

13. Ky ajet është plot me shprehje të figurshme. Krijimi përmes Isait<sup>as</sup> në këtë ajet është në kuptimin shpirtëror, siç kjo përmendet edhe për Profetin Muhammed<sup>saws</sup> në 8:25. Kjo sepse krijimi i jetës si fenomen në Kuranin e Shenjtë i atribuohet vetëm Zotit të Madhërisëm (13:17; 16:21; 22:74; 25:4; 31:11-12; 35:41; 46:5). Përveç kësaj, Kurani i Shenjtë na tregon se është kundër praktikës së Zotit që një i vdekur të kthehet sërish në këtë botë (21:96). Përgatitja e trajtës së shpendit nga balta dhe fryrja në të për ta shndërruar atë në shpend është një metaforë, që tregon se nga frymëzimi i Mesihut njerëzit tokësorë fluturonin në lartësi shpirtërore. Po kështu, edhe të verbrin e lindur dhe të lebrosurit ishin ata që nuk patën ndonjëherë shikimin shpirtëror dhe që zemrat i kishin të qelbura. Edhe Kurani i Shenjtë në shumë ajete na bën të qartë që nuk verbohen sytë, por zemrat që janë në kraharorë (22:47). Ky është edhe kuptimi i ngjalljes së të vdekurit. Ky ajet tregon se çfarë mrekullie solli Hazret Isai<sup>as</sup> përmes lutjes. Dhe ngaqë ai adhurohet pa të drejtë në vend të Zotit, është theksuar se të gjitha mrekullitë e tij ndodhën për shkak se ai ishte rob i Zotit. Shkaku i disa kategorive të mrekullisë, në fakt, është pranimi i lutjes. Burimi i mijëra mrekullive që kanë treguar Profetët, si dhe i të gjitha gjërave të jashtëzakonshme që kanë treguar *evlijatë* deri më sot, në të vërtetë është lutja. Lexoni 8:25.

Zotit tuaj. Prandaj, druhuni nga Allahu dhe më ndiqni mua!

وَاطِيعُونَ ﴿٥١﴾

52. Pa dyshim, Allahu është Zoti im dhe Zoti juaj. Prandaj, Atë adhurojeni! Kjo është rrugë e drejtë.”

إِنَّ اللَّهَ رَبِّي وَرَبُّكُمْ فَاعْبُدُوهُ ۗ هَذَا صِرَاطٌ مُسْتَقِيمٌ ﴿٥٢﴾

53. Kur Isai ndjeu mohimin te ta, tha: “Cilët do të jenë ndihmësit e mi (për të thirrur) drejt Allahut?” Dishepujt thanë: “Ne jemi ndihmësit e Allahut! Besuam në Allah, dhe ji dëshmitar që ne jemi të nënshtruar!”

فَلَمَّا أَحَسَّ عِيسَىٰ مِنْهُمُ الْكُفْرَ قَالَ مَنْ أَنْصَارِي إِلَى اللَّهِ ۗ قَالَ الْحَوَارِيُّونَ نَحْنُ أَنْصَارُ اللَّهِ ۗ آمَنَّا بِاللَّهِ ۗ وَأَشْهَدُ بِأَنَّا مُسْلِمُونَ ﴿٥٣﴾

54. O Zoti ynë! Besuam atë që na ke zbritur dhe e ndoqëm të Dërguarin. Prandaj, na shëno si dëshmitarë!”

رَبَّنَا آمَنَّا بِمَا أَنْزَلْتَ وَاتَّبَعْنَا الرَّسُولَ فَاكْتُبْنَا مَعَ الشَّاهِدِينَ ﴿٥٤﴾

55. Edhe ata<sup>14</sup> bënë strategji, edhe Allahu bëri strategji. Allahu është strategu më i mirë.<sup>15</sup>

وَمَكَرُوا وَمَكَرَ اللَّهُ ۗ وَاللَّهُ خَيْرٌ الْمَكْرِينِ ﴿٥٥﴾

56. Kur Allahu tha: O Isa! Unë sigurisht që do të të marr shpirtin,<sup>16</sup> do të të ngre drejt Vetes, do të të liroj nga ata që mohuan, dhe ndjekësit e tu do t'i bëj eprorë, deri në Ditën e Kiametit mbi ata që mohuan. Pastaj, tek Unë do të jetë kthimi juaj, atëherë do t'ju gjykoj në çështjet ku kundërshtonit njëri-tjetrin.<sup>17</sup>

إِذْ قَالَ اللَّهُ لِعِيسَىٰ إِنِّي مُتَوَفِّيكَ وَرَافِعُكَ إِلَيَّ وَمُطَهِّرُكَ مِنَ الَّذِينَ كَفَرُوا وَجَاعِلُ الَّذِينَ اتَّبَعُوكَ فَوْقَ الَّذِينَ كَفَرُوا إِلَىٰ يَوْمِ الْقِيَامَةِ ۗ ثُمَّ إِلَىٰ مَرْجِعِكُمْ فَأَحْكُمُ بَيْنَكُمْ فِيمَا كُنْتُمْ فِيهِ تَخْتَلِفُونَ ﴿٥٦﴾

14. Mohuesit e Isait.

15. Këto ajete hedhin dritë mbi ngjarjen e famshme të Kryqëzimit, duke treguar se hebrenjtë (judenjtë) bënë një plan për ta kryqëzuar Hazret Isain<sup>as</sup>, por edhe Zoti bëri një plan për ta shpëtuar atë dhe plani i Zotit ishte më i miri. Për faktet Biblike në lidhje me këtë ngjarje, lexoni ajetet 4:157-159.

16. Në Kuranin e Shenjtë rreth 25 herë vjen fjala *teveffa* dhe çdo herë ajo është në kuptimin e marrjes së shpirtit dhe në asnjë vend nuk e ka kuptimin e marrjes edhe të trupit dhe të shpirtit bashkë. Këto janë ajetet: 2:235; 2:241; 3:56; 3:194; 4:16; 4:98; 5:118; 6:61; 6:62; 7:38; 7:127; 8:51; 10:47; 10:105; 12:102; 13:41; 16:29; 16:33; 16:71; 22:6; 32:12; 39:43; 40:68; 40:78; 47:28.

17. Në këtë ajet, së pari përmendet “do të të marr shpirtin”, pastaj “do të të ngre drejt Vetes”.



57. Për sa u përket atyre që mohuan, do t'i ndëshkoj shumë rëndë edhe në këtë botë, edhe në *ahiret*, dhe ata nuk do të gjejnë ndihmës.

فَأَمَّا الَّذِينَ كَفَرُوا فَعَذَّبْنَا عَذَابًا  
شَدِيدًا فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ وَمَا لَهُمْ  
مَنْ نُصْرِينَ ﴿٥٧﴾

58. Kurse ata që besuan dhe bënë të mira, Ai do t'ua kthejë atyre me shpërblime të plota. Allahu nuk i do të padrejtët.

وَأَمَّا الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ  
فَيُوَفِّيهِمْ أَجْرَهُمْ ط وَاللَّهُ لَا يُحِبُّ  
الظَّالِمِينَ ﴿٥٨﴾

59. Këto janë disa prej shenjave dhe (prej) kujtimit urtiplotë që Ne i lexojmë para teje.

ذَلِكَ نَتْلُوهُ عَلَيْكَ مِنَ الْآيَاتِ وَالذِّكْرِ  
الْحَكِيمِ ﴿٥٩﴾

60. Sigurisht, shembulli i Isait tek Allahu është si shembulli i Ademit, të cilin Ai e krijoi prej dheu dhe më pas tha: “Bëhu!”, dhe ai zuri të bëhej.<sup>18</sup>

إِنَّ مَثَلَ عِيسَىٰ عِنْدَ اللَّهِ كَمَثَلِ آدَمَ ط خَلَقَهُ  
مِنْ تُرَابٍ ثُمَّ قَالَ لَهُ كُنْ فَيَكُونُ ﴿٦٠﴾

61. Kjo është e vërteta prej Zotit tënd, andaj, mos u bëj prej dyshuesve.

الْحَقُّ مِنْ رَبِّكَ فَلَا تَكُنْ مِنَ  
الْمُمْتَرِينَ ﴿٦١﴾

62. Ai që grindet me ty në këtë çështje, edhe pse ty të ka ardhur dija, atëherë thuaji: “Ejani të thërrasim bijtë tanë e bijtë tuaj, gratë tona e gratë tuaja, njerëzit tanë e njerëzit

فَمَنْ حَاجَّكَ فِيهِ مِنْ بَعْدِ مَا جَاءَكَ مِنَ  
الْعِلْمِ فَقُلْ تَعَالَوْا نَدْعُ أَبْنَاءَنَا  
وَ أَبْنَاءَكُمْ وَ نِسَاءَنَا وَ نِسَاءَكُمْ

Ndonëse “do të të ngre drejt Vetes” do të thotë ngritje në pozitë, megjithatë, ky ajet sjell argument të pamohueshëm për të gjithë ata që insistojnë të nxjerrin kuptimin e ngritjes fizike të *Hazret Isait*<sup>as</sup>. Pra, ajeti thotë se ngritja e *Isait*<sup>as</sup> u bë vetëm pas vdekjes dhe kjo tregon se ngritja e tij ka qenë shpirtërore dhe jo fizike. Përveç kësaj, sipas Kuranit, udhëtimi ose ngritja e robit drejt Zotit nuk bëhet fizikisht por shpirtërisht. Shikoni: 51:51; 7:176-177; 19:57-58; 89:29-31.

18. Krahasimi i *Hazret Isait*<sup>as</sup> me *Hazret Ademin*<sup>as</sup> vjen për shkak se *Hazret Ademi*, edhe pse ishte krijatur me dhe përmes urdhrit të Zotit, kur tha: “Bëhu!”, por prapëseprapë ai ishte njeri. Në të njëjtën mënyrë, edhe *Hazret Isai*<sup>as</sup> është njeri, që lindi me të njëjtin dekret Hyjnor. Përveç kësaj, fjalët “Bëhu!, dhe ai bëhet” hedhin dritë edhe mbi zanafillën e krijimit të njeriut. Kur Zoti vendosi të krijojë njeriun, tha “Bëhu!” dhe njeriu filloi të bëhej, për të shkuar drejt përsosmërisë së tij.

tuaj dhe të lutemi me përgjërim që mallkimi i Allahut të bjerë mbi gënjeshtarët!”

63. Sigurisht, kjo është deklarata e vërtetë. Nuk ka asnjë të adhurueshëm tjetër përveç Allahut dhe sigurisht, Allahu është i Plotfuqishmi, i Urti.

64. Po ia kthyen shpinën, (dije se) Allahu i njuh mirë ngatërrestarët.

65. Thuaj: “O ithtarët e Librit!<sup>19</sup> Ejani te një fjalë e përbashkët midis nesh dhe jush që, të mos adhurojmë dikë tjetër përveç Allahut, të mos barazojmë asgjë me Të dhe askush nga ne të mos marrë për zot dikë tjetër përveç Allahut.” Nëse do t’ia kthejnë shpinën, thojani: “Jini dëshmitarë se ne jemi të nënshtruar.<sup>20</sup>”

66. O ithtarët e Librit! Përse grindeni për Ibrahimin, kur Teurati dhe Inxhili kanë zbritur vetëm pas tij? A nuk kuptoni?

67. Ishit ju, pra, që u grindët për çështje, për të cilat keni pasur dijeni. E tani, përse grindeni në çështje për të cilat nuk keni dijeni? Allahu di, kurse ju nuk dini.

68. Ibrahimin nuk qe as hebre, as i krishterë, porse i përkushtuar dhe i nënshtruar (ndaj Allahut) dhe nuk ishte as prej idhujtarëve.

وَأَنْفُسَنَا وَأَنْفُسَكُمْ ۖ ثُمَّ نَبْتَهِلُ فَنَجْعَلُ لَعْنَتَ اللَّهِ عَلَى الْكٰذِبِينَ ﴿١٩﴾

إِنَّ هٰذَا لَهُوَ الْقَصَصُ الْحَقُّ ۚ وَمَا مِنْ إِلٰهٍ إِلَّا اللَّهُ ۗ وَإِنَّ اللَّهَ لَهُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ﴿٢٠﴾

يٰۤاَيُّهَا الَّذِيْنَ كَفَرُوْا اِنَّ اللَّهَ عَلِيْمٌۢ بِاِمْفٰسِدِيْنَۙ ﴿٢١﴾

قُلْ يٰۤاَهْلَ الْكِتٰبِ تَعٰلَوْا اِلٰى كَلِمَةٍ سَوَآءٍ بَيْنَنَا وَبَيْنَكُمْ اِلَّا نَعْبُدَ اِلَّا اللَّهَ وَلَا نَشْرِكُ بِهٖ شَيْۤا ۚ وَلَا يَتَّخِذَ بَعْضُنَا بَعْضًا اَرْبَابًا مِّنْ دُوْنِ اللَّهِ ۗ فَاِنْ تَوَلَّوْا فَعُقُوْا الشُّهَدَآءَ بِاَنَّا مُسْلِمُوْنَ ﴿٢٢﴾

يٰۤاَهْلَ الْكِتٰبِ لِمَ تُحَاجُّوْنَ فِىْ اِبْرٰهِيْمَ وَمَا اُنزِلَتْ التَّوْرَةُ وَالْاِنْجِيْلُ اِلَّا مِنْۢ بَعْدِهٖ ۗ اَفَلَا تَعْقِلُوْنَ ﴿٢٣﴾

هَآءَنتُمْ هٰۤؤُلَآءِ حَآجَجْتُمْ فِىْمَا لَكُمْ بِهٖ عِلْمٌ فَلِمَ تُحَاجُّوْنَ فِىْمَا لَيْسَ لَكُمْ بِهٖ عِلْمٌ ۗ وَاللَّهُ يَعْلَمُ ۗ وَاَنْتُمْ لَا تَعْلَمُوْنَ ﴿٢٤﴾

مَا كَانَ اِبْرٰهِيْمُ يَهُودِيًّا وَّ لَا نَصْرَانِيًّا وَّلٰكِنْ كَانَ حَنِيفًا مُّسْلِمًا ۗ وَمَا كَانَ مِنَ الْمُشْرِكِيْنَ ﴿٢٥﴾

19. *Ithtarët e Librit* do të thotë ata që ndjekin një Libër të shpallur. Në terminologjinë e Kuranit, ky togfjalësh shpesh u referohet hebrenjve dhe të krishterëve.

20. Muslimanë.

69. Sigurisht, njerëzit më pranë Ibrahimit janë ata që e kanë ndjekur atë, ky Profet dhe ata që besuan gjithashtu. Allahu është Mik i besimtarëve.

70. Një grup i ithtarëve të Librit dëshiron që sikur t'ju shpjerë në humbje, por ata vetëm vetveten e çojnë në humbje dhe nuk e kuptojnë.

71. O ithtarët e Librit! Përse mohoni shenjat e Allahut, edhe pse i shikoni?

72. O ithtarët e Librit! Përse i vishni së vërtetës të rremën, dhe pse e fshihni të vërtetën, edhe pse e dini atë?!

73. Një grup nga ithtarët e Librit tha: “Besojeni paradite atë që u është zbritur besimtarëve dhe pasdite mohojeni, që ndoshta (edhe) ata do të kthehen (nga ajo);

74. dhe mos besoni askënd, përveç atij që ndjek fenë tuaj”. Thuaju: Udhëzimi i vërtetë është udhëzimi i Allahut. (Nuk është e domosdoshme) që t'i jepet dikujt e njëjta gjë që ju është dhënë edhe juve, ose (nëse nuk do t'u jepej udhëzimi, ata do të kishin të drejtën) të grinden me ju pranë Zotit tuaj. Thuaju: Bekimi pa dyshim është në dorë të Allahut. Ai ia jep kujt të dojë. Allahu është Zgjerues, i Gjithëdhijshëm.

إِنَّ أَوْلَى النَّاسِ بِإِبْرَاهِيمَ لَلَّذِينَ اتَّبَعُوهُ  
وَهَذَا النَّبِيُّ وَالَّذِينَ آمَنُوا وَاللَّهُ وَلِيُّ  
الْمُؤْمِنِينَ ﴿٦٩﴾

وَدَّتْ طَائِفَةٌ مِّنْ أَهْلِ الْكِتَابِ لَوْ  
يَضُلُّوكُمْ<sup>ط</sup> وَمَا يُضِلُّونَ إِلَّا أَنفُسَهُمْ وَمَا  
يَشْعُرُونَ ﴿٧٠﴾

يَا أَهْلَ الْكِتَابِ لِمَ تَكْفُرُونَ بِآيَاتِ اللَّهِ  
وَأَنْتُمْ تَشْهَدُونَ ﴿٧١﴾

يَا أَهْلَ الْكِتَابِ لِمَ تَلْبِسُونَ الْحَقَّ بِالْبَاطِلِ  
وَتَكْتُمُونَ الْحَقَّ وَأَنْتُمْ تَعْلَمُونَ ﴿٧٢﴾

وَقَالَتْ طَائِفَةٌ مِّنْ أَهْلِ الْكِتَابِ  
أُمُومًا بِالَّذِي أُُنزِلَ عَلَى الَّذِينَ آمَنُوا  
وَجَاءَ النَّهَارَ وَكَفَرُوا وَآخَرَهُ لَعَلَّهُمْ  
يَرْجِعُونَ ﴿٧٣﴾

وَلَا تُؤْمِنُوا إِلَّا لِمَنْ تَبِعَ دِينَكُمْ<sup>ط</sup> قُلْ  
إِنَّ الْهُدَىٰ هُدَىٰ اللَّهِ<sup>ل</sup> أَنْ يُؤْتَىٰ أَحَدٌ  
مِّثْلَ مَا أُوتِيتُمْ أَوْ يُحَاجُّوكُمْ عِنْدَ  
رَبِّكُمْ<sup>ط</sup> قُلْ إِنَّ الْفَضْلَ بِيَدِ اللَّهِ<sup>ع</sup> يُؤْتِيهِ  
مَنْ يَشَاءُ<sup>ط</sup> وَاللَّهُ وَاسِعٌ عَلِيمٌ ﴿٧٤﴾

75. Ai zgjedh kë të dojë për mëshirën e Tij dhe Allahu zotëron bekim të madh.

76. Ndër ithtarët e Librit ka të atillë që nëse i lë amanet edhe thesare të shumta, do t'i kthejë dhe, po prej tyre ka syresh që nëse i lë amanet qoftë një dinar, nuk do të ta kthejë, përveçse t'i rrish shqipe mbi kokë. Kjo ndodh për shkak se ata thanë: “Nuk mbajmë përgjegjësi për analfabetët”. Ata thonë gënjeshtren për Allahun, edhe pse e dinë.

77. Dëgjoni! E vërteta është se kushdo që plotëson premtimin e tij dhe ka drujtje, (ta dijë se) Allahu i do ata që kanë drujtje.

78. Sigurisht, ata që këmbejnë besën e Allahut dhe premtimet e tyre me një çmim të vogël,<sup>21</sup> nuk do të kenë pjesë në *ahiret* dhe, edhe Allahu nuk do të flasë me ta, nuk do të shohë drejt tyre Ditën e Kiametit dhe nuk do t'i pastrojë ata. Për ta do të jetë ndëshkim i dhimbshëm.

79. Prej tyre,<sup>22</sup> pa dyshim, ka një grup që e dredhojnë gjuhën duke lexuar Librin, me qëllim që ju ta besoni se ajo është prej Librit, kurse ajo nuk është prej Librit. Dhe ata thonë se ajo është prej Allahut, kurse ajo nuk është prej Allahut. Ata thonë gënjeshtren për Allahun, edhe pse e dinë.

يَخْتَصُّ بِرَحْمَتِهِ مَنْ يَشَاءُ ۗ وَاللَّهُ ذُو الْفَضْلِ الْعَظِيمِ ﴿٧٥﴾

وَمِنْ أَهْلِ الْكِتَابِ مَنْ إِنْ تَأْمَنَهُ بِقِنطَارٍ يُودِّدْهُ إِلَيْكَ ۗ وَمِنْهُمْ مَن إِنْ تَأْمَنَهُ بِدِينَارٍ لَّا يُؤدِّدْهُ إِلَيْكَ إِلَّا مَا دُمَّتْ عَلَيْهِ قَائِمًا ۗ ذٰلِكَ بِأَنَّهُمْ قَالُوا لَيْسَ عَلَيْنَا فِي الْأُمِّيِّينَ سَبِيلٌ ۗ وَ يَقُولُونَ عَلَى اللَّهِ الْكُذِبَ وَهُمْ يَعْلَمُونَ ﴿٧٦﴾

بَلَىٰ مَنْ أَوْفَىٰ بِعَهْدِهِ وَاتَّقَىٰ فَإِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُتَّقِينَ ﴿٧٧﴾

إِنَّ الَّذِينَ يَشْتَرُونَ بِعَهْدِ اللَّهِ وَأَيْمَانِهِمْ ثَمًّا قَلِيلًا أُولَٰئِكَ لَا خَلَاقَ لَهُمْ فِي الْآخِرَةِ وَلَا يَكَلِّمُهُمُ اللَّهُ وَلَا يَنْظُرُ إِلَيْهِمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ ۗ وَلَا يُرَكِّبُهُمْ ۗ وَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿٧٨﴾

وَإِنَّ مِنْهُمْ لَفَرِيقًا يَلْوَنَ أَسْتَهْمُ بِالْكِتَابِ لِيُحْسَبُوهُ مِنَ الْكِتَابِ وَمَا هُوَ مِنَ الْكِتَابِ ۗ وَ يَقُولُونَ هُوَ مِنْ عِنْدِ اللَّهِ وَمَا هُوَ مِنْ عِنْدِ اللَّهِ ۗ وَ يَقُولُونَ عَلَى اللَّهِ الْكُذِبَ وَهُمْ يَعْلَمُونَ ﴿٧٩﴾

21. Lexoni 2:175.

22. Prej ithtarëve të Librit.

80. Nuk është e mundur për një njeri që atij t'i japë Allahu Librin, urtësinë dhe profetërinë dhe ai t'u thotë njerëzve: “Bëhuni adhuresit e mi e jo të Allahut!” Përkundrazi, (ai thotë:) “Bëhuni të Zotit, sepse këtë e mësoni nga Libri dhe këtë e lexoni!”

مَا كَانَ لِبَشَرٍ أَنْ يُؤْتِيَهُ اللَّهُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَ وَالنَّبُوءَةَ ثُمَّ يَقُولَ لِلنَّاسِ كُونُوا عِبَادًا لِي مِنْ دُونِ اللَّهِ وَلَكِنْ كُونُوا رَبَّيْنَ بِمَا كُنْتُمْ تُعَلِّمُونَ الْكِتَابَ وَبِمَا كُنْتُمْ تَدْرُسُونَ ﴿٤٠﴾

81. Dhe ai as nuk ju porositi që t'i merrni për zota engjëjt dhe Profetët. A mund t'ju porositi ai për mohimin, pasi jeni bërë të nënshtruar?!

وَلَا يَأْمُرُكُمْ أَنْ تَتَّخِذُوا الْمَلَائِكَةَ وَالنَّبِيِّينَ أَرْبَابًا ۗ أَيَأْمُرُكُمْ بِالْكُفْرِ بَعْدَ إِذْ أَنْتُمْ مُسْلِمُونَ ﴿٤١﴾

82. Kur Allahu mori besëlidhjen nga Profetët: “Kurdo që t'ju vijë ndonjë i dërguar, pasi ju kam dhënë diçka nga Libri dhe urtësia, dhe ai të jetë vërtetues i asaj që ju e keni, duhet ta besoni dhe duhet ta ndihmoni atë”. Tha: “A e pranoni dhe lidhni me Mua besën për këtë gjë?” Ata thanë: “E pranojmë”. Ai tha: “Jini dëshmitarë, edhe Unë do të jem dëshmitar bashkë me ju!”<sup>23</sup>

وَإِذْ أَخَذَ اللَّهُ مِيثَاقَ النَّبِيِّينَ لَمَا آتَيْتُكُمْ مِنْ كِتَابٍ وَحِكْمَةٍ ثُمَّ جَاءَكُمْ رَسُولٌ مُصَدِّقٌ لِمَا مَعَكُمْ لَتُؤْمِنُنَّ بِهِ وَتَنْصُرْتَهُ ۗ قَالَ ءَأَقْرَضْتُمْ وَآخَذْتُمْ عَلَىٰ ذُلِكُمْ إِصْرِي ۗ قَالُوا أَقْرَضْنَا ۗ قَالَ فَاشْهَدُوا ۗ وَأَنَا مَعَكُمْ مِنَ الشَّاهِدِينَ ﴿٤٢﴾

83. Ata që do t'ia kthejnë shpinën pas kësaj, do të jenë të ligj.

فَمَنْ تَوَلَّىٰ بَعْدَ ذَلِكَ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْفٰسِقُونَ ﴿٤٣﴾

84. Ata a kërkojnë diçka tjetër përveç fesë së Allahut, kurse Atij i

أَفَعَيِّرَ دِينَ اللَّهِ يَعْجُونَ وَلَهُ أَسْلَمَ مَنْ فِي

23. Kurani i Shenjtë përmend dy besëlidhje: atë që u bë me bijtë e Izraelit, si dhe atë që u bë me Profetët dhe kjo e fundit ishte bërë edhe me Profetin Muhammed<sup>saws</sup> (Kurani 33:8). Përmbajtja e saj është që Zoti u kërkon besë të gjithë Profetëve që sa herë që u vjen ndonjë i dërguar prej Tij, me të njëjtin mesazh që ata sollën, ata nuk do ta mohojnë atë, madje do ta vërtetojnë dhe do ta ndihmojnë atë. Duhet shpjeguar që të Dërguarit nuk u vijnë të Dërguarve, por popujve të tyre, andaj, kuptimi është që të Dërguarit duhet t'i porosisin popujt e tyre që sa herë që do t'u vijë ndonjë i dërguar, i cili të jetë edhe vërtetues i të Dërguarve të mëparshëm, ata nuk do ta mohojnë atë, madje duhet ta ndihmojnë.

është nënshtruar çdokush që gjendet në qiej e në tokë, me hir e pa hir, dhe tek Ai do të kthehen?!

85. Thuaj: Ne besuam në Allah, në atë që na është zbritur neve, në atë që i ishte zbritur Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit dhe bijve (të tij) dhe në atë që i ishte dhënë Musait, Isait dhe Profetëve prej Zotit të tyre. Nuk bëjmë ndarje midis asnjërit prej tyre dhe Atij i jemi nënshtruar.

86. Kushdo që kërkon ndonjë fe tjetër përveç Islamit, kurrsesi nuk do të pranohet prej tij. Edhe në *ahiret*, ai do të jetë ndër të humburit.

87. Si t'i udhëzojë Allahu njerëzit që mohuan, pasi patën besuar një herë dhe patën dëshmuar se i Dërguari është i vërtetë dhe atyre u kishin ardhur edhe shenjat?! Allahu nuk udhëzon popullin e padrejtë.

88. Pikërisht këta do ta kenë si dënim mallkimin e Allahut, të engjëjve dhe të gjithë njerëzve.

89. Në të do të jetojnë për një kohë të gjatë. Atyre as nuk do t'u pakësohet dënimi dhe as nuk do t'u jepet afat.

90. Përveç atyre që u penduan dhe e përmirësuan veten pas kësaj, sepse, Allahu pa dyshim është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ طَوْعًا وَكَرْهًا وَإِلَيْهِ  
يُرْجَعُونَ ﴿٨٥﴾

قُلْ أُمَّتًا لِلَّهِ وَمَا أُنزِلَ عَلَيْنَا وَمَا أُنزِلَ  
عَلَىٰ إِبْرَاهِيمَ وَإِسْمَاعِيلَ وَإِسْحَاقَ وَيَعْقُوبَ  
وَ الْأَسْبَاطِ وَمَا أُوتِيَ مُوسَىٰ وَعِيسَىٰ  
وَالنَّبِيِّينَ مِنْ رَبِّهِمْ ۚ لَا نُنْفِركَ بَيْنَ أَحَدٍ  
مِّنْهُمْ ۗ وَنَحْنُ لَهُ مُسْلِمُونَ ﴿٨٦﴾

وَمَنْ يَبْتَغِ غَيْرَ الْإِسْلَامِ دِينًا فَلَنْ يُقْبَلَ  
مِنَهُ ۗ وَهُوَ فِي الْآخِرَةِ مِنَ الْخَاسِرِينَ ﴿٨٧﴾

كَيْفَ يَهْدِي اللَّهُ قَوْمًا كَفَرُوا بَعْدَ  
إِيمَانِهِمْ وَ شَهِدُوا أَنَّ الرَّسُولَ حَقٌّ  
وَجَاءَهُمُ الْبَيِّنَاتُ ۗ وَاللَّهُ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ  
الظَّالِمِينَ ﴿٨٨﴾

أُولَٰئِكَ جَزَاءُهُمْ أَنَّ عَلَيْهِمْ لَعْنَةَ اللَّهِ  
وَالْمَلَائِكَةِ وَالنَّاسِ أَجْمَعِينَ ﴿٨٩﴾

خُلْدِينَ فِيهَا ۗ لَا يُخَفَّفُ عَنْهُمُ الْعَذَابُ  
وَلَا هُمْ يُنظَرُونَ ﴿٩٠﴾

إِلَّا الَّذِينَ تَابُوا مِنْ بَعْدِ ذَٰلِكَ وَأَصْلَحُوا ۗ  
فَإِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَّحِيمٌ ﴿٩١﴾

91. Ata që mohuan, pasi patën besuar, dhe u shtuan në mohim, atyre kursesi nuk do t'u pranohet pendesa dhe pikërisht ata janë të devijuar.

إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا بَعْدَ إِيمَانِهِمْ ثُمَّ  
أَرَادُوا كُفْرًا لَنْ نَقْبَلَ تَوْبَهُمْ ۚ  
وَأُولَٰئِكَ هُمُ الضَّالُّونَ ﴿٩١﴾

92. Ata që mohuan dhe vdiqën në gjendje mohimi, nuk do t'i pranohet asnjërit prej tyre, edhe sikur të sjellë si shpërblese flori sa e gjithë toka. Këta do të kenë ndëshkim të dhimbshëm dhe nuk do të kenë asnjë ndihmë.

إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا وَمَاتُوا وَهُمْ كُفَّارًا فَلَنْ  
يُقْبَلَ مِنْ أَحَدِهِمْ مِلَّةٌ الْأَرْضَ ذَهَبًا  
وَلَوْ أَقْدَىٰ بِهِ ۗ أُولَٰئِكَ لَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ  
ۖ وَمَا لَهُمْ مِنْ نَاصِرِينَ ﴿٩٢﴾

Xhuzi 4

93. Kursesi nuk mund të arrini mirësinë, derisa të shpenzoni nga ato që i keni përzemër. Çfarëdo gjëje që të shpenzoni, Allahu është i Gjithëdijshëm për të.

لَنْ تَنَالُوا الْبِرَّ حَتَّى تُنْفِقُوا مِمَّا تَحِبُّونَ ۗ  
وَمَا تُنْفِقُوا مِنْ شَيْءٍ فَإِنَّ اللَّهَ بِهِ  
عَلِيمٌ ﴿٩٣﴾

94. Të gjitha ushqimet ishin të lejuara për bijtë e Izraelit, përveç asaj që vetë Izraeli<sup>24</sup> ndaloi për veten e tij, përpara se të zbritet Teurati. Thuaju: Silleni Teuratin dhe lexojeni, nëse jeni të vërtetë!

كُلُّ الطَّعَامِ كَانَ حَلَالًا لِّبَنِي إِسْرَائِيلَ إِلَّا  
مَا حَرَّمَ إِسْرَائِيلُ عَلَىٰ نَفْسِهِ مِنْ قَبْلِ أَنْ  
تُنزَلَ التَّوْرَةُ ۗ قُلْ فَأْتُوا بِالتَّوْرَةِ  
فَأْتَوْهَا إِنْ كُنْتُمْ صَادِقِينَ ﴿٩٤﴾

95. E kushdo që shpif gënjeshtër mbi Allahun pas kësaj, pikërisht ai do të jetë keqbërës.

فَمَنْ أَفْتَرَىٰ عَلَى اللَّهِ الْكُذْبَ مِنْ بَعْدِ  
ذَلِكَ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الظَّالِمُونَ ﴿٩٥﴾

96. Thuaju: Allahu e tha të vërtetën. Prandaj, ndiqeni grupin e Ibrahimit të nënshtruar (ndaj Zotit), dhe ai nuk ishte nga idhujtarët.

قُلْ صَدَقَ اللَّهُ ۗ فَاتَّبِعُوا مِلَّةَ إِبْرَاهِيمَ  
حَنِيفًا ۗ وَمَا كَانَ مِنَ الْمُشْرِكِينَ ﴿٩٦﴾

97. Sigurisht, shtëpia e parë që u vu për njerëzit, ishte ajo që është

إِنَّ أَوَّلَ بَيْتٍ وُضِعَ لِلنَّاسِ لَلَّذِي بِبَكَّةَ

24. Emri tjetër i Hazret Jakubit<sup>as</sup> ishte Izrael, të cilin Zoti ia dhuroi në një *keshf* (vizion) të tij. (Bibla, Zanafilla 32:28).

në Bek-keh, që është e bekuar dhe udhëzuese për botët.<sup>25</sup>

مُبْرَكًا وَهُدًى لِّلْعَالَمِينَ ﴿١٧﴾

98. Në të ka shenja të qarta; qëndrimin e Ibrahimit. Kushdo që hyn në të, është në paqe. Njerëzit kanë detyrim ndaj Allahut që të bëjnë haxhin e Shtëpisë (së Tij), (domethënë) ai që ka mundësi për të shkuar drejt saj. Dhe ai që mohon, (le ta dijë se) Allahu është i Vetëmjaftueshëm karshi botëve.<sup>26</sup>

فِيهِ آيَاتٌ بَيِّنَاتٌ مَّقَامُ إِبْرَاهِيمَ ۖ وَمَنْ دَخَلَهُ كَانَ آمِنًا ۗ وَلِلَّهِ عَلَى النَّاسِ حِجُّ الْبَيْتِ مَنِ اسْتَطَاعَ إِلَيْهِ سَبِيلًا ۚ وَمَنْ كَفَرَ فَإِنَّ اللَّهَ عَنَىٰ عَنِ الْعَالَمِينَ ﴿١٨﴾

99. Thuaju: “O ithtarët e Librit! Pse mohoni ajetet e Allahut, ndërkohë që Allahu është Dëshmitar i asaj që bëni?!”.

قُلْ يَا أَهْلَ الْكِتَابِ لِمَ تَكْفُرُونَ بِآيَاتِ اللَّهِ ۗ وَاللَّهُ شَهِيدٌ عَلَىٰ مَا تَعْمَلُونَ ﴿١٩﴾

25. Këtu për “shtëpinë e parë” është thënë se ajo është “ndërtuar për njerëzit”, pra nuk është thënë “ndërtuar për Allahun”. Duket se ky ajet shpalos faktin që pikërisht Qabeja ishte shtëpia që i dha civilizim njeriut, i cili deri më parë jetonte nëpër shpella. Për këtë arsye, për Mekën në këtë ajet është përmendur Bek-keh, që është edhe emri i saj i lashtë. Lexoni edhe 2:128.

26. Haxhi është adhurimi i Zotit në një nivel shumë të lartë, madje shkalla e fundit e adhurimit për kërkimtarin e Zotit. Vetëmohimi i vërtetë i robit për hir të Zotit i kërkon që ai të përhumbet në dashurinë për Zotin, aq shumë sa të mos i duket i vështirë asnjë mundim, asnjë udhëtim, të mos merakoset as për pasurinë, e as për jetën, as për veten e as për familjen; si një i dashuruar që bëhet gati të flijojehet për personin që do shumë. Pikërisht këtë pamje dhe këtë ndjesi na jep haxhi. Ashtu siç një i dashuruar sillet rreth shtëpisë së personit që e do shumë, gjatë haxhit edhe besimtari sillet rreth Shtëpisë së Zotit. Por duhet të kemi parasysh, se Qabeja është Shtëpia e Allahut në formën fizike. Ne nuk adhurojmë Shtëpinë e Allahut, por Zotin e asaj Shtëpie, kurse *tavaf* përfaqëson simbolikisht adhurimin tonë plot dashuri ndaj Allahut. Haxhiu nuk merret as me zbulimin e trupit të tij, madje vishet sa për ta mbuluar veten, për të treguar përlulesinë e skajshme ndaj Allahut dhe shkëputjen e tij totale nga bota materiale. Pra, vetëm ai *tavaf* është i dobishëm që i ka edhe elementet shpirtërore. Dhe ai që bën një *tavaf* të tillë, edhe gjatë jetës së tij vërtitet vetëm rreth pëlqimit të Allahut, duke qenë tërësisht vetëmohues. Kjo metodë nuk ka asnjë *shirk*. Njeriu kur merr thjesht një letër nga i dashuri i tij, e puth dhe e lexon me gjithë zemër. Në të njëjtën mënyrë, asnjë musliman nuk e adhuron as Qabenë, e as i lutet gurit të zi, por ato i quan vetëm shenja të caktuara prej Allahut. Njësoj kur ne bëjmë sexhde në namaz, sexhdeja jonë nuk është për tokën, por për Atë që na dha këtë porosi. Guri është vetëm gur që nuk sjell as dobi e as dëm, por ai erdhi nga dora e të Dashurit, i cili e quajti gur të pragut të Tij. *Hazret Omeri*<sup>ra</sup> thoshte – Pasha Allahun! Unë e di që ti je thjesht një gur, që nuk sjell as dobi e as dëm, por e kam parë të Dërguarin e Allahut duke të puthur ty, andaj po të puth edhe unë. (Buhari, nr. 1597).



100. Thuaju: “O ithtarët e Librit! Pse e pengoni nga rruga e Allahut atë që besoi, duke dashur shtrembësi në këtë (rrugë), ndonëse vetë jeni dëshmitarë?! Allahu nuk është i pavëmendshëm ndaj asaj që bëni.

101. O ju që besuat! Nëse do të ndiqni ndonjë grup prej atyre që u është dhënë Libri, ata do t’ju kthejnë në mohues, edhe pse keni pranuar besimin.

102. E si mund të mohoni, kurse juve ju lexohen ajetet e Allahut dhe keni të Dërguarin e Tij mes jush?! Ai që e kap fuqimisht Allahun, është i udhëzuar në rrugë të drejtë.

103. O ju që besuat! Kini druajtje ndaj Allahut, ashtu siç duhet t’i druheni Atij, dhe kurrresi mos vdisni, përveçse kur të jeni të nënshtruar!<sup>27</sup>

104. Të gjithë kapeni fuqimisht litarin e Allahut dhe mos u përçani! Kujtojeni bekimin e Allahut që keni mbi vete: kur keni qenë armiq, Ai jua lidhi zemrat, dhe ju, falë mirësisë së Tij, u bëtë vëllezër; dhe ishit buzë një greminë prej zjarri dhe Ai ju shpëtoi prej saj. Kështu ju shpjegon Allahu ajetet e Tij, që ju të udhëzoheni.

105. Duhet të jetë një grup prej jush, që thërrasin për mirësi, urdhërojnë për të drejtën dhe ndalojnë nga

قُلْ يَا هَلْ الْكِتَابِ لِمَ تَصُدُّونَ عَن  
سَبِيلِ اللَّهِ مَنُ آمَنَ تَبِعُونَهَا عَوَجًا وَ أَنْتُمْ  
شُهَدَاءُ ۗ وَمَا اللَّهُ بِعَافٍ لِّ عَمَّا تَعْمَلُونَ ﴿١٠٠﴾

يَأَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِن تَطِيعُوا فَرِيقًا  
مِّنَ الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ يَرُدُّوكُم بَعْدَ  
إِيمَانِكُمْ كُفْرِينَ ﴿١٠١﴾

وَكَيْفَ تَكْفُرُونَ وَأَنْتُمْ تُتْلَىٰ عَلَيْكُمْ آيَاتُ  
اللَّهِ وَفِيكُمْ رَسُولُهُ ۗ وَمَنْ يَعْتَصِم بِاللَّهِ  
عَٰجِدًا فَقَدْ هَدَىٰ إِلَىٰ صِرَاطٍ مُّسْتَقِيمٍ ﴿١٠٢﴾

يَأَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ حَقَّ تَقَاتِهِ  
وَلَا تَمُوتُنَّ إِلَّا وَأَنْتُمْ مُسْلِمُونَ ﴿١٠٣﴾

وَاعْتَصِمُوا بِحَبْلِ اللَّهِ جَمِيعًا وَلَا تَفَرَّقُوا ۗ  
وَإِذْ كُرُوا نِعْمَتَ اللَّهِ عَلَيْكُمْ إِذْ كُنْتُمْ  
أَعْدَاءً فَأَلَّفَ بَيْنَ قُلُوبِكُمْ فَأَصْبَحْتُمْ  
بِنِعْمَتِهِ إِخْوَانًا ۗ وَكُنْتُمْ عَلَىٰ شَفَا حُفْرَةٍ  
مِّنَ النَّارِ فَأَنْقَذَكُمْ مِنْهَا ۗ كَذَلِكَ يُبَيِّنُ  
اللَّهُ لَكُمْ آيَاتِهِ لَعَلَّكُمْ تَهْتَدُونَ ﴿١٠٤﴾

وَلْتَكُنْ مِنْكُمْ أُمَّةٌ يَدْعُونَ إِلَى الْخَيْرِ  
وَيَأْمُرُونَ بِالْمَعْرُوفِ وَيَنْهَوْنَ عَنِ

27. Lexoni 2:133.

ligësia.<sup>28</sup> Pikërisht këta janë të suksesshmit.

106. Dhe mos u bëni si ata që u përçanë dhe kundërshtuan, pasi u kishin ardhur shenjat. E pikërisht këta do të kenë ndëshkim të madh.

107. Ditën kur disa fytyra do të zbardhen e disa fytyra do të nxihen, atyre që do t'u nxihen fytyrat<sup>29</sup> (do t'u thuhet): “A mohuat, pasi e patët pranuar besimin? Shijojeni ndëshkimin për atë që mohoni!”

108. Kurse ata të cilëve do t'u zbardhen fytyrat, do të jenë në mëshirën e Allahut. Në të do të qëndrojnë përgjithmonë.

109. Këto janë ajetet e Allahut, që Ne t'i lexojmë ty me vërtetësi. Allahu nuk do asnjë padrejtësi ndaj botëve.

110. E Allahut është ajo që gjendet në qiej dhe ajo që gjendet në tokë dhe tek Allahu do të kthehen të gjitha çështjet.

الْمُنْكَرِ ۗ وَأُولَٰئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ ﴿١٠٦﴾

وَلَا تَكُونُوا كَالَّذِينَ تَفَرَّقُوا وَاخْتَلَفُوا  
مِنْ بَعْدِ مَا جَاءَهُمُ الْبَيِّنَاتُ ۗ وَأُولَٰئِكَ  
لَهُمْ عَذَابٌ عَظِيمٌ ﴿١٠٧﴾

يَوْمَ تَبْيَضُّ وُجُوهٌ وَتَسْوَدُّ وُجُوهٌ ۚ فَأَمَّا  
الَّذِينَ اسْوَدَّتْ وُجُوهُهُمْ ۖ أَكَفَرْتُمْ  
بَعْدَ إِيمَانِكُمْ فَذُوقُوا الْعَذَابَ بِمَا كُنْتُمْ  
تَكْفُرُونَ ﴿١٠٨﴾

وَأَمَّا الَّذِينَ ابْيَضَّتْ وُجُوهُهُمْ فَفِي  
رَحْمَةِ اللَّهِ ۗ هُمْ فِيهَا خَالِدُونَ ﴿١٠٩﴾

تِلْكَ آيَاتُ اللَّهِ تَتْلُوهَا عَلَيْكَ ۖ بِالْحَقِّ ۗ وَمَا  
اللَّهُ بِرَبِيدٍ ظَلْمًا لِلْعَالَمِينَ ﴿١١٠﴾

وَلِلَّهِ مَا فِي السَّمٰوٰتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ ۗ  
وَإِلَى اللَّهِ تُرْجَعُ الْأُمُورُ ﴿١١١﴾

28. I Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> tha – “Kur dikush prej jush sheh diçka të keqe, le ta largojë atë me dorën e tij. Nëse nuk e bën dot këtë, le të ndalojë të tjerët përmes gojës së tij. Nëse nuk e bën dot as këtë, le të ndiejë urrejtje për të në zemrën e tij, por ky është besimi më i dobët.” (Muslimin, kitab: “El-Iman”, bab: “Bejanu keuni-nehji 'anil-munkeri” nr. 177) Lexoni edhe 3:115.

29. Pra, gjendjet shpirtërore nuk do të mbeten të fshehta, por do të shfaqen fizikisht. (Lexoni edhe 11:106).

111. Ju jeni populli më i mirë që është nxjerrë për njerëzimin.<sup>30</sup> Ju urdhëroni për të drejtën, ndaloni nga ligësia dhe besoni në Allah. Nëse edhe ithtarët e Librit do të besonin, do të ishte mirë për ta. Ka besimtarë prej tyre, por shumica prej tyre janë të ligj.

كُنْتُمْ خَيْرَ أُمَّةٍ أُخْرِجَتْ لِلنَّاسِ تَأْمُرُونَ  
بِالْمَعْرُوفِ وَتَنْهَوْنَ عَنِ الْمُنْكَرِ  
وَأُوْمِنُونَ بِاللَّهِ ۗ وَلَوْ آمَنَ أَهْلُ الْكِتَابِ  
لَكَانَ خَيْرًا لَهُمْ ۗ مِنْهُمْ الْمُؤْمِنُونَ  
وَكَثُرُهُمُ الْفَاسِقُونَ ﴿٣١﴾

112. Ata kurrsesi nuk mund t'ju dëmtojnë, përveç ndonjë shqetësimi. E nëse luftojnë me ju, do t'jua kthejnë shpinën dhe më pas, nuk do të gjejnë ndihmës.

لَنْ يَضُرُّوكُمْ إِلَّا أَذَىٰ ۗ وَإِنْ يُضَارِبُوا  
يُؤْتُوكُمْ الْأَدْبَارَ ۖ ثُمَّ لَا يُضُرُّونَ ﴿٣٢﴾

113. Ata i zuri poshtërimi kudo që u gjendën, përveç atyre që janë në ndoren e Allahut dhe në ndoren e njerëzve. Ata tërhoqën zemërimin e Allahut dhe i zuri mjerimi. Kjo ndodhi për shkak se ata i mohonin shenjat e Allahut dhe i vrisnin<sup>31</sup> Profetët pa të drejtë. Kjo ndodhi sepse ata bënë shkelje dhe se e tepronin.

ضَرَبَتْ عَلَيْهِمُ الذَّلِيلَةَ ۚ آيُنَ مَا تُقِفُوا إِلَّا  
يَحْبِلُ مِنَ اللَّهِ وَحَبْلِ مِنَ النَّاسِ وَبَاءُ وُ  
بِغَضَبٍ مِنَ اللَّهِ وَضَرَبَتْ عَلَيْهِمُ الْمَسْكَنَةَ ۗ  
ذَلِكَ بِأَنَّهُمْ كَانُوا يَكْفُرُونَ بِآيَاتِ اللَّهِ  
وَيَقْتُلُونَ الْأَنْبِيَاءَ بِغَيْرِ حَقٍّ ۗ ذَلِكَ بِمَا  
عَصَوْا وَكَانُوا يَعْتَدُونَ ﴿٣٣﴾

114. Ata nuk janë të gjithë njëloj. Ka një grup prej ithtarëve të Librit, që është i qëndrueshëm (në parimet e drejta). Ata recitojnë ajetet e Allahut gjatë orëve të natës dhe bëjnë sexhde.

لَيْسُوا سَوَاءً ۗ مِنْ أَهْلِ الْكِتَابِ أُمَّةٌ  
قَائِمَةٌ يَتْلُونَ آيَاتِ اللَّهِ آنَاءَ اللَّيْلِ  
وَهُمْ يَسْجُدُونَ ﴿٣٤﴾

30. Arsyeja pse ky umet është quajtur më i miri është që muslimanët janë krijuar jo për dobinë e vet, por për dobinë e të gjithë botës. Sikur ta kuptonim këtë porosi, do të ishim dobiprurës për të gjithë botën!

31. Në arabisht fjala "katele", përveç kuptimit të vrasjes ka edhe kuptimin e persekutimit me qëllime vrastare, dhe pikërisht ky duhet të jetë kuptimi edhe në këtë ajet. Sepse, historikisht bijtë e Izraelit nuk arritën t'i vrisnin Profetët, edhe pse tentuan disa herë. Për të mësuar më shumë rreth këtij kuptimi të fjalës "katele", shihni fjalorin "Lisan-ul-arab".

115. Ata besojnë në Allah dhe në Ditën e *Ahiretit*, urdhërojnë për të drejtën dhe ndalojnë nga ligësia dhe garojnë në mirësi. E pikërisht këta janë të dëlirë.<sup>32</sup>

116. Çfarëdo mirësie që të bëjnë ata, në asnjë mënyrë nuk do t'u mohohet. Allahu është i Gjithëdijshëm për ata që kanë drujtje.

117. Ata që mohuan, nuk do t'u vijnë në ndihmë aspak as pasuritë e tyre e as bijtë e tyre kundër Allahut. Pikërisht këta janë banorë të zjarrit, në të cilin do të mbesin gjatë.

118. Shembulli i asaj që ata e shpenzojnë në jetën e kësaj bote është si i erës që ka acar; ajo u zë arën njerëzve që i bëjnë keq vetvetes, duke ua shkatërruar atë. Allahu nuk u bëri keq atyre, por ata i bënë keq vetvetes.<sup>33</sup>

119. O ju që besuat! Mos bëni shokë të ngushtë njerëzit jashtë gjirit tuaj, që nuk ngurrojnë t'ju shqetësojnë.

يُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ وَيَأْمُرُونَ  
بِالْمَعْرُوفِ وَيَنْهَوْنَ عَنِ الْمُنْكَرِ  
وَيَسَارِعُونَ فِي الْخَيْرَاتِ وَأُولَئِكَ مِنَ  
الصَّالِحِينَ ﴿١١٥﴾

وَمَا يَفْعَلُوا مِنْ خَيْرٍ فَلَنْ يُكْفَرُوهُ وَاللَّهُ  
عَلِيمٌ بِالْمُتَّقِينَ ﴿١١٦﴾

إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا لَنْ تُعْنِيَ عَنْهُمْ  
أَمْوَالُهُمْ وَلَا أَوْلَادُهُمْ مِنَ اللَّهِ شَيْئًا  
وَأُولَئِكَ أَصْحَابُ النَّارِ هُمْ فِيهَا  
خَالِدُونَ ﴿١١٧﴾

مَثَلُ مَا يُنْفِقُونَ فِي هَذِهِ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا  
كَمَثَلِ رِيحٍ فِيهَا صِرٌّ أَصَابَتْ حَرْثَ  
قَوْمٍ ظَلَمُوا أَنفُسَهُمْ فَأَهْلَكَتْهُمُ وَمَا  
ظَلَمَهُمُ اللَّهُ وَلَكِنْ أَنفُسَهُمْ يَظْلِمُونَ ﴿١١٨﴾

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَتَّخِذُوا بِطَانَةً  
مِنْ دُونِكُمْ لَا يَأْلُونَكُمْ خَبَالًا وَدُّوا مَا

32. Ashtu siç nuk duhet të themi diçka që është kundër pëlqimit të Allahut, në të njëjtën mënyrë, duhet edhe të shprehim të vërtetën. E tillë duhet të jetë vetia e besimtarit. Megjithatë, para se ta zbatosh porosinë që përmendet në këtë ajet, duhet të provosh me vepra edhe gjendjen tënde, që ti e ke cilësinë shpirtërore për të cilën po flet, sepse është e nënkuptuar që të mirën që dëshiron ta përhapësh te të tjerët për dobinë e tyre, ajo së pari duhet të të ketë dhënë dobi edhe ty. Gjithashtu, për të urdhëruar për të drejtën dhe për të ndaluar nga e keqja, duhet të shohësh vendin dhe momentin. Po ashtu, mënyra e të porositurit të jetë e butë dhe e drejtë, dhe kurrësi të mos jetë e zbrazët nga drujtja ndaj Allahut. Lexoni edhe 3:105.

33. Njeriu shpenzon paratë për të përparuar, por ata që shpenzojnë me hipokrizi, shpenzimi i tyre i ngjan një ere të ftohtë e cila shkatërron arën. Në të njëjtën mënyrë, edhe shpenzimi i tyre do t'ua prishë veprat, në vend që t'ua përmirësojë.

Ata e duan atë që ju mundon ju. Mëria tashmë është shfaqur nga goja e tyre dhe ajo që e fshehin zemrat e tyre është më e madhe. Ne jua kemi shpjeguar qartë ajetet, nëse kuptoni.<sup>34</sup>

120. Ja, jeni ju që i doni, kurse ata nuk ju duan, dhe ju besoni në të gjithë Librin. Kur ata ju takojnë, (ju) thonë: “Ne besuam”, dhe kur veçohen, kafshojnë majat e gishtave të tyre nga mllefi. Thuaju: Vdisni me mllefin tuaj! Allahu është i Gjithëdijshëm për gjithçka që mbajnë kraharorët.

121. Nëse ju vjen ndonjë e mirë, ata shqetësohen, e nëse ju godet ndonjë e keqe, gëzohen nga kjo. E nëse do të duroni e t'i druheni (Zotit), aspak nuk mund t'ju dëmtojnë intrigat e tyre. Allahu i ka vënë rreth asaj që bëjnë ata.

122. Dhe (kujuje) kur u ndave në mëngjes nga familja jote për t'i caktuar besimtarët në pozicionet e tyre në betejë. Allahu është Gjithëdëgjues, i Gjithëdijshëm;

123. kur dy çeta prej jush vendosën të tregoheshin burracakë, edhe pse Allahu ishte Kujdestari i tyre. Tek Allahu duhet të mbështeten besimtarët.

124. Allahu ju ndihmoi në Bedër, kur ju ishit të dobët. Prandaj, druajuni Allahut që të bëheni mirënjohës;

عِنْتُمْ ۚ قَدْ بَدَتِ الْبُغْضَاءُ مِنْ أَفْوَاهِهِمْ ۗ  
وَمَا تُخْفِي صُدُورُهُمْ أَكْبَرُ ۗ قَدْ بَيَّنَّا  
لَكُمْ الْآيَاتِ إِنْ كُنْتُمْ تَعْقِلُونَ ﴿١٢٠﴾

هَآئِنْتُمْ أَوْلَآءِ تُحِبُّونَهُمْ وَلَا يُحِبُّونَكُمُ  
وَتُؤْمِنُونَ بِالْكِتَابِ كُلِّهِ ۗ وَإِذَا لَقُوكُمْ  
قَالُوا آمَنَّا ۗ وَإِذَا خَلَوْا عَضُّوا عَلَيْكُمُ  
الْأَنَامِلَ مِنَ الْغَيْظِ ۗ قُلْ مُؤْتُوا بَعْضِكُمْ  
إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ بِذَاتِ الصُّدُورِ ﴿١٢٠﴾

إِنْ تَمَسَّكُمُ حَسَنَةٌ تَسُؤْهُمْ ۗ وَإِنْ  
تُصِيبْكُمُ سَيِّئَةٌ يَفْرَحُوا بِهَا ۗ وَإِنْ تَصْبِرُوا  
وَتَتَّقُوا لَا يَضُرُّكُمْ كَيْدُهُمْ شَيْئًا ۗ إِنَّ  
اللَّهَ بِمَا يَعْمَلُونَ مُحِيطٌ ﴿١٢١﴾

وَإِذْ عَدَوْتَ مِنْ أَهْلِكَ ۗ تُبَوِّئُ الْمُؤْمِنِينَ  
مَقَاعِدَ لِلْقِتَالِ ۗ وَاللَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ ﴿١٢٢﴾

إِذْ هَمَّتْ طَّآئِفَتَيْنِ مِنْكُمْ أَنْ تَفْشَلَا  
وَاللَّهُ وَلِيَهُمَا ۗ وَ عَلَى اللَّهِ فَلْيَتَوَكَّلِ  
الْمُؤْمِنُونَ ﴿١٢٣﴾

وَلَقَدْ نَصَرَكُمُ اللَّهُ بِبَدْرٍ ۗ وَأَنْتُمْ أَذِلَّةٌ ۗ  
فَاتَّقُوا اللَّهَ لَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ ﴿١٢٤﴾

34. Lexoni 60:9-10.

125. Kur u thoshe besimtarëve:  
“A nuk ju mjafton që Zoti juaj t’ju  
përforcojë me tre mijë engjëj të  
zbritur?!”

إِذْ تَقُولُ لِلْمُؤْمِنِينَ أَلَنْ يَكْفِيَكُمْ أَنْ  
يُمَدِّدَ رَبُّكُمْ بِثَلَاثَةِ آفٍ مِنَ الْمَلَائِكَةِ  
مُنزَلِينَ ۝١٢٥

126. Pse jo! Nëse do të duroni e t’i  
druheni (Zotit) dhe (armiqtë) t’ju  
vërsulen me këtë vrull që kanë, Zoti  
juaj do t’ju përforcojë me pesë mijë  
engjëj ndëshkues.

بَلَىٰ إِنْ تَصْبِرُوا وَتَتَّقُوا وَيَأْتُوكُم مِّنْ  
فَوْرِهِمْ هَذَا يُمَدِّدْكُمْ رَبُّكُمْ بِخَمْسَةِ  
آفٍ مِنَ الْمَلَائِكَةِ مُسَوِّمِينَ ۝١٢٦

127. Këtë (premtim) Allahu jua bëri  
vetëm si sihariq dhe që t’ju qetësohen  
zemrat prej tij. Ndiham vjen vetëm  
prej Allahut të Plotfuqishëm, të Urtë.

وَمَا جَعَلَهُ اللَّهُ إِلَّا بُشْرَىٰ لَكُمْ وَلِتَطْمَئِنَّ  
قُلُوبُكُمْ بِهِ ۗ وَمَا النَّصْرُ إِلَّا مِنْ عِنْدِ اللَّهِ  
الْعَزِيزِ الْحَكِيمِ ۝١٢٧

128. (Dhe) që Ai t’u copëtojë një pjesë  
atyre që mohuan ose t’i poshtërojë,  
dhe ata të kthehen të humbur.

لِيَقْطَعَ طَرَفًا مِّنَ الَّذِينَ كَفَرُوا أَوْ  
يَكْتَبَهُمْ فَيَقْلَبُوا خَائِبِينَ ۝١٢٨

129. Ti nuk ke asgjë në dorë. Ai  
në dashtë ua pranon pendesën, në  
dashtë i ndëshkon, ata janë keqbërës.

لَيْسَ لَكَ مِنَ الْأَمْرِ شَيْءٌ أَوْ يَتُوبَ  
عَلَيْهِمْ أَوْ يُعَذِّبُهُمْ فَلَهُمْ ظُلْمُونَ ۝١٢٩

130. E Allahut është ajo që gjendet  
në qiej dhe ajo që gjendet në tokë.  
Ai fal kë të dojë dhe ndëshkon kë të  
dojë dhe Allahu është shumë Falës,  
shumë Mëshirëbërës.

وَلِلَّهِ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ ط يَعْرِضُ  
لِمَنْ يَشَاءُ وَيُعَذِّبُ مَنْ يَشَاءُ ۗ وَاللَّهُ  
عَفُورٌ رَّحِيمٌ ۝١٣٠

131. O ju që besuat! Mos hani  
kamatën, të shtuar e të shumëfishuar!  
Kini druajtje ndaj Allahut, që të  
gëzoni sukses!

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَأْكُلُوا الرِّبَا  
أَضْعَافًا مُّضَاعَفَةً ۗ وَاتَّقُوا اللَّهَ لَعَلَّكُمْ  
تُفْلِحُونَ ۝١٣١

132. Frikësohuni nga zjarri që është i  
përgatitur për mohuesit!

وَاتَّقُوا النَّارَ الَّتِي أُعِدَّتْ لِلْكَافِرِينَ ۝١٣٢

133. Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit, që të mëshiroheni!

وَاطِيعُوا اللَّهَ وَ الرَّسُولَ لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ ﴿١٣٣﴾

134. Dhe vraponi drejt faljes së Zotit tuaj dhe xhenetit që ka gjerësinë e qiejve e të tokës, që është i përgatitur për të druajturit.<sup>35</sup>

وَسَارِعُوا إِلَىٰ مَغْفِرَةٍ مِّن رَّبِّكُمْ وَجَنَّةٍ عَرْضُهَا السَّمَاوَاتُ وَالْأَرْضُ ۗ أُعِدَّتْ لِلْمُتَّقِينَ ﴿١٣٤﴾

135. Që shpenzojnë edhe në kamje, edhe në skamje, që gëlltitin zemërimin dhe falin njerëzit. Dhe Allahu i do mirëbërësit.<sup>36</sup>

الَّذِينَ يُنْفِقُونَ فِي السَّرَّاءِ وَالضَّرَّاءِ وَالْكُظُمِينَ الْغَيْظِ وَالْعَافِينَ عَنِ النَّاسِ ۗ وَاللَّهُ يُحِبُّ الْمُحْسِنِينَ ﴿١٣٥﴾

136. Dhe që kur bëjnë ndonjë paturpësi, ose shkelin veten e tyre, e kujtojnë Allahun dhe i kërkojnë falje për mëkatet e tyre – e kush mund t'i falë mëkatet, përveç Allahut! – dhe

وَالَّذِينَ إِذَا فَعَلُوا فَاحِشَةً أَوْ ظَلَمُوا أَنفُسَهُمْ ذَكَرُوا اللَّهَ فَاسْتَغْفَرُوا لِذُنُوبِهِمْ ۗ وَمَن يَغْفِرَ الذُّنُوبَ إِلَّا

35. Ky ajet tregon se xheneti nuk është ndonjë vend fizik diku sipër qiejve, sepse ajeti thotë se xheneti është aq i gjerë sa krejt qiejt dhe toka. Kur zbriti ky ajet, dikush e pyeti Profetin<sup>savs</sup> – Nëse xheneti është i shtrirë mbi të gjithë qiejt e tokën, ku ndodhet xhehenemi? Profeti<sup>savs</sup> iu përgjigj: “Subhanallah! Ku shkon nata, kur agon dita?!” (Musned Ahmed, nr. 15100; Raziu 3:133). Do të thotë se edhe xhehenemi aty është, por ju nuk e ndieni. Kështu që, koncepti se xheneti e xhehenemi kanë toka të ndryshme, është i gabuar. Në të njëjtën gjithësi banojnë të dy banorët, edhe të xhenetit, edhe të xhehenemit. Kjo gjithashtu tregon se Allahu i Madhërishëm i kishte treguar Profetit Muhammed<sup>savs</sup> një koncept të relativitetit, pra, dy gjëra që mund të jenë në të njëjtin vend, por për shkak të dimensioneve të tyre të ndryshme, ato nuk përzihen me njëra-tjetrën.

36. Në kohën kur Islami u shfaq në botë, skllavëria ishte një dukuri normale në shoqërinë njerëzore. Islami ndërmori masa të atilla që ajo gradualisht do të zhdukej. Duke iu referuar këtij ajeti, në historinë islame përmendet një ngjarje. Njëherë, një skllav i sollti një filxhan çaj Imam Husejnit<sup>ra</sup>, nipit të Profetit<sup>savs</sup>. Kur i ishte afruar shumë, filxhani i ra nga dora dhe çaji u derdh mbi Imam Husejnin<sup>ra</sup> mu në kokë, gjë që i shkaktoi sëkëlldi. I zemëruar e pa skllavin. Ky i fundit citoi fjalët e këtij ajeti “ata që gëlltitin zemërimin”. – E gëlltita –, iu përgjigj Imam Husejnit<sup>ra</sup>. Por dihet që ai që gëlltit zemërimin, vetëm se përmbahet dhe nuk e fal fajtorin. Andaj, skllavi vijoi ta citonte ajetin – “dhe falin njerëzit”. – Ta kam falur –, i tha Imam Husejnit<sup>ra</sup>. Të dashurit e Zotit janë vetëm ata që pas gëlltitjes së zemërimit dhe pas faljes, bëjnë edhe mirësi. Andaj, skllavi e citoi edhe pjesën e fundit të ajetit – “Allahu i do mirëbërësit”. – Ti je i lirë nga sot e tutje –, i tha Imam Husejnit<sup>ra</sup>. (Tabersi, “Mexhme’ul-Bejan...” nën 3:134). Pra, skllavi gëzoi lirinë pasi i derdhi filxhanin e çajit padronit të tij. Përsosmëria e mësimin është ajo që e përsos edhe karakterin e njeriut.

ata nuk këmbëngulin me vetëdije për ato që kanë bërë.

اللَّهُ ۖ وَلَمْ يُصِرُّوا عَلَىٰ مَا فَعَلُوا وَهُمْ يَعْلَمُونَ ﴿١٣٧﴾

137. Shpërblimi i këtyre do të jetë falje prej Zotit të tyre dhe xhenete, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Në to do të jetojnë përgjithmonë. Sa shpërblim i mirë është ky për punëtorët!

أُولَٰئِكَ جَزَاءُ هُمْ مَغْفِرَةٌ مِّن رَّبِّهِمْ وَجَنَّاتٌ تَجْرِي مِن تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا ۖ وَنَعَمَ أَجْرُ الْعَمِلِينَ ﴿١٣٨﴾

138. Para jush kanë kaluar shumë praktika (jetese). Ndaj, udhëtoni nëpër tokë dhe shikoni se si ka qenë fundi i mohuesve.

قَدْ خَلَتْ مِن قَبْلِكُمْ سُنَنٌ ۖ فَسِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَانظُرُوا كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ الْمُكْذِبِينَ ﴿١٣٩﴾

139. Ky është një tregim për njerëzit, një udhëzim dhe këshillë për ata që kanë druajtje.

هَٰذَا بَيَانٌ لِّلنَّاسِ وَهُدًى وَ مَوْعِظَةٌ لِّلْمُتَّقِينَ ﴿١٤٠﴾

140. Mos u dobësoni dhe mos u pikëlloni, se ju do të jeni triumfues, nëse do të jeni besimtarë!

وَلَا تَهَمُّوا وَلَا تَحْزَنُوا وَأَنْتُمْ الْأَعْلَوْنَ ۚ إِن كُنْتُمْ مُّؤْمِنِينَ ﴿١٤١﴾

141. Nëse keni marrë plagë, edhe populli (kundërshtar) ka marrë plagë të tillë. Ditët e tilla Ne i ndërrojmë midis njerëzve, që Allahu t'i provojë ata që besuan dhe të zgjedhë dëshmorë prej jush. Allahu nuk i do mizorët.

إِن يَمَسُّكُمْ فَرْحٌ فَقَدْ مَسَّ الْقَوْمَ فَرْحٌ مِّثْلَهُ ۗ وَتِلْكَ الْأَيَّامُ نُدَاوِلُهَا بَيْنَ النَّاسِ ۗ وَلِيَعْلَمَ اللَّهُ الَّذِينَ أَمْؤُوا وَيَتَّخِذَ مِنْكُمْ شُهَدَاءَ ۗ وَاللَّهُ لَا يُحِبُّ الظَّالِمِينَ ﴿١٤٢﴾

142. Dhe që Allahu t'i pastrojë mirë ata që besuan dhe t'i zhdokë mohuesit.

وَلِيُمَحِّصَ اللَّهُ الَّذِينَ أَمْؤُوا وَيَمَحَقَ الْكٰفِرِينَ ﴿١٤٣﴾

143. A menduat që do të hyni në xhenet, ndonëse Allahu ende nuk ka provuar se cilët prej jush bënë xhihad

أَمْ حَسِبْتُمْ أَنْ تُدْخَلُوا الْجَنَّةَ وَلَمَّا يَعْلَمِ اللَّهُ الَّذِينَ جَاهَدُوا مِنْكُمْ وَيَعْلَمَ



dhe që janë të duruarit?!

الصَّابِرِينَ ﴿١٤٧﴾

144. Dhe ju dëshironit vdekjen përpara se ta ndeshnit. E tani që u ballafaquat, (vetëm) po e shikonit.

وَلَقَدْ كُنْتُمْ تَمَنَّوْنَ الْمَوْتَ مِنْ قَبْلِ أَنْ تَلْقَوْهُ فَقَدْ رَأَيْتُمُوهُ وَأَنْتُمْ تَنْظُرُونَ ﴿١٤٤﴾

145. Dhe Muhammedi është vetëm një i Dërguar. Të Dërguarit para tij kanë kaluar. Pra, nëse ai vdes ose vritet, a do t'u ktheheni gjurmëve tuaja?! Dhe ai që u kthehet gjurmëve të veta, aspak nuk e dëmton dot Allahun. Allahu me siguri do t'i shpërblejë mirënjohësit.<sup>37</sup>

وَمَا مُحَمَّدٌ إِلَّا رَسُولٌ قَدْ خَلَتْ مِنْ قَبْلِهِ الرُّسُلُ أَفَإِنْ مَاتَ أَوْ قُتِلَ انْقَلَبْتُمْ عَلَى أَعْقَابِكُمْ وَمَنْ يَنْقَلِبْ عَلَى عَقْبَيْهِ فَلَنْ يَصُرَ اللَّهُ شَيْئًا وَسَيَجْزِي اللَّهُ الشَّاكِرِينَ ﴿١٤٥﴾

146. Asnjë shpirt nuk mund të vdesë pa vendimin e Allahut. Afat i caktuar! Ai që do shpërblimin e botës, ia japim prej saj dhe ai që do shpërblimin e *ahiretit*, ia japim prej tij. Ne me siguri do t'i shpërblejmë mirënjohësit.

وَمَا كَانَ لِنَفْسٍ أَنْ تَمُوتَ إِلَّا بِإِذْنِ اللَّهِ كِتَابًا مُؤَجَّلًا وَمَنْ يُرِدْ ثَوَابَ الدُّنْيَا نُؤْتِهِ مِنْهَا وَمَنْ يُرِدْ ثَوَابَ الْآخِرَةِ نُؤْتِهِ مِنْهَا وَسَجْزِي الشَّاكِرِينَ ﴿١٤٦﴾

147. Sa e sa profetë kanë qenë, që bashkë me ta luftuan shumë (njerëz) të Zotit! Ata nuk u dobësuan për shkak të asaj që i goditi në rrugën e Allahut. As nuk u ligështuan e

وَكَأَيِّنْ مِنْ نَبِيِّ قُتِلَ مَعَهُ رَبِّيُونَ كَثِيرٌ فَمَا وَهَنُوا لِمَا أَصَابَهُمْ فِي سَبِيلِ اللَّهِ وَمَا ضَعُفُوا وَمَا اسْتَكَانُوا وَاللَّهُ

37. Ky ajet pohon kategorikisht edhe vdekjen e *Hazret Isait*<sup>as</sup>, siç tha se Muhammedi nuk ishte më shumë se një i Dërguar i Allahut dhe të gjithë të Dërguarit para tij kanë vdekur. Në arabisht, fjala arabe *khala* d.m.th. *kaloi* në një kontekst si ky, nuk ka kuptimin e kalimit në rrugë, por e ka kuptimin e vdekjes, pra, kaloi në botën tjetër. Prandaj, nëse *Hazret Isai*<sup>as</sup> ishte i Dërguar i Zotit, patjetër që ka vdekur. Konsensusi i parë i sahabëve të Profetit Muhammed<sup>savs</sup> gjithashtu ishte për vdekjen e të gjithë Profetëve të mëparshëm. Ditën kur ndërroi jetë Profeti<sup>savs</sup>, shumë sahabë, nga pikëllimi i thellë, e humbën kontrollin. *Hazret Omeri*<sup>ra</sup> thoshte – Kushdo që thotë se i Dërguari i Allahut ka vdekur, unë do t'ia pres kokën! Vetëm kur erdhi *Hazret Ebu Bekri*<sup>ra</sup>, i qetësoi sahabët duke lexuar pikërisht këtë ajet të Kuranit, për të provuar se si të gjithë profetët, edhe i Dërguari i Allahut ka ndërruar jetë (Buhari, nr. 4452). Atëherë edhe *Omeri*<sup>ra</sup>, edhe sahabët e tjerë u bindën. Asnjë sahab atë ditë nuk e kundërshtoi *Ebu Bekri*<sup>ra</sup> duke thënë – Jo, e ke gabim; *Isai*<sup>as</sup> është i gjallë akoma!, – edhe pse ai ishte Profeti më i fundit para Profetit Muhammed<sup>savs</sup>. Lexoni edhe 5:76.

as nuk u mposhtën. Allahu i do të durueshmit.

148. Fjala e tyre nuk ishte, veçse: “O Zoti ynë! Na fal mëkatet tona dhe teprimin në çështjet tona, na forco këmbët dhe na ndihmo kundër popullit mohues!”

149. Këtyre Allahu ua dha edhe shpërblimin e botës, edhe shpërblimin më të mirë të *ahiretit*. Allahu i do mirëbërësit.

150. O ju që besuat! Nëse do t'i ndiqni ata që mohuan, do t'ju kthejnë në gjurmët tuaja dhe kështu ju do të ktheheni të humbur.

151. Në të vërtetë Allahu është Miku juaj dhe Ai është ndihmësi më i mirë.

152. Ne do të fusim frikë në zemrat e mohuesve për shkak se ata i atribuuan ortak Allahut, për të cilin Ai nuk zbriti asnjë argument. Vendqëndrimi i tyre është zjarri. Sa vendqëndrim të keq kanë të padrejtët!

153. Sigurisht, Allahu ka përmbushur premtimin e Tij ndaj jush, kur ju po i asgjësonit ata me urdhrin e Tij; derisa kur u trembët dhe u grindët në lidhje me porosinë dhe e shkelët atë, edhe pse Ai jua kishte treguar atë që donit. Prej jush ka që duan botën dhe prej jush ka që duan *ahiretin*. Më pas, Ai ju largoi prej tyre, që t'ju sprovovjë. Ai pa dyshim që ju ka falur. Allahu ka bekim të madh për besimtarët.

يُحِبُّ الصَّابِرِينَ ﴿١٤٨﴾

وَمَا كَانَ قَوْلَهُمْ إِلَّا أَنْ قَالُوا رَبَّنَا اغْفِرْ لَنَا  
ذُنُوبَنَا وَإِسْرَافَنَا فِي أَمْرِنَا وَثَبِّتْ أقدامَنَا  
وَأَنْصُرْنَا عَلَى الْقَوْمِ الْكَافِرِينَ ﴿١٤٩﴾

فَأَسْأَلُهُمُ اللَّهُ ثَوَابَ الدُّنْيَا وَحَسَنَ ثَوَابِ  
الْآخِرَةِ ۗ وَاللَّهُ يُحِبُّ الْمُحْسِنِينَ ﴿١٥٠﴾

يَأَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِن تَطِيعُوا الَّذِينَ  
كَفَرُوا يُرَدُّوكُمْ عَلَىٰ أَعْقَابِكُمْ فَانْقَلِبُوا  
خُسْرَيْنِ ﴿١٥١﴾

بَلِ اللَّهُ مَوْلَاكُمْ ۖ وَهُوَ خَيْرُ النَّاصِرِينَ ﴿١٥٢﴾

سَنُلْقِي فِي قُلُوبِ الَّذِينَ كَفَرُوا الرُّعْبَ  
بِمَا أَشْرَكُوا بِاللَّهِ مَا لَمْ يُنَزَّلْ بِهِ  
سُلْطَانًا وَمَأْوَاهُمُ النَّارُ ۗ وَبِئْسَ مَثْوَى  
الظَّالِمِينَ ﴿١٥٣﴾

وَلَقَدْ صَدَقَكُمُ اللَّهُ وَعْدَهُ إِذْ تَحْسَبُونَهُمْ  
بِأَذْنِهِ ۖ حَتَّىٰ إِذَا فَشِلْتُمْ وَتَنَارَعْتُمْ فِي  
الْأَمْرِ وَعَصَيْتُمْ مِمَّن بَعْدَ مَا أَرْكَبْتُمْ  
مُحِبُّونَ ۗ مِمَّن مَّن يُرِيدُ الدُّنْيَا وَمِمَّن مَّن  
يُرِيدُ الْآخِرَةَ ۗ ثُمَّ صَرَفَكُمْ عَنْهُمْ  
لِيَبْتَلِيَكُمْ ۗ وَلَقَدْ عَفَا عَنْكُمْ ۗ وَاللَّهُ  
ذُو فَضْلٍ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ ﴿١٥٤﴾

154. Tek vraponit dhe nuk kthenit kokën pas për askënd, ndërsa i Dërguari ju thërriste nga çeta tjetër, atëherë Ai ju goditi me një brengë pas një brengje tjetër, që ju të mos pikëlloheshit për atë që ju ka humbur dhe për atë që ju ka goditur. Allahu është i Gjithinformuar për atë që bëni.

155. Pas brengës, Ai ju zbriti përgjumje qetësuese, që kaploi një grup prej jush, kurse një grup tjetër ishin ata që shqetësoheshin vetëm për jetën e tyre. Kishin mendim të padrejtë rreth Allahut, mendim prej injorance. Thoshin: “A na takon edhe neve ndonjë pjesë në vendimmarrje?” Thuaju: E gjithë vendimmarrja është e Allahut”. Ata fshehin në zemrat e tyre atë që nuk ta tregojnë ty. Thoshin: “Po të kishim ndonjë pjesë në vendimmarrje, nuk do të vriteshim këtu”. Thuaju: Edhe sikur të ishit në shtëpitë tuaja, atyre që u ishte shkruar të vriteshin, do të dilnin pashmangshmërisht në vendet ku do të binin. (Kjo ndodhi) që Allahu ta sprovtojë atë që kanë kraharorët tuaj dhe ta pastrojë mirë atë që kanë zemrat tuaja. Allahu është i Gjithëdijshëm për gjithçka që mbajnë kraharorët.

156. Pa dyshim, prej jush ata që treguan shpinën ditën kur u ndeshën dy ushtritë, i lëkundit djalli për shkak të disa veprave të tyre që ata bënë. Allahu i ka falur. Sigurisht, Allahu është shumë Falës, shumë i Përmbajtur.

إِذْ تُصْعِدُونَ وَلَا تَلُونَ عَلَىٰ أَحَدٍ  
وَالرَّسُولُ يَدْعُوكُمْ فِي أُحْرَابِكُمْ  
فَأَثَابَكُمْ غَمًّا بِغَمِّ لَكَيْلًا تَحَرَّوْا  
عَلَىٰ مَا فَاتَكُمْ وَلَا مَا أَصَابَكُمْ ۗ وَاللَّهُ  
خَبِيرٌ بِمَا تَعْمَلُونَ ﴿٥٩﴾

ثُمَّ أَنْزَلَ عَلَيْكُم مِّن بَعْدِ الْغَمِّ أَمَنَةً  
نُّعَاسًا يَغْشَىٰ طَآئِفَةً مِّنكُمْ ۗ وَطَآئِفَةٌ  
قَدْ أَهَمَّتَهُمْ أَنفُسُهُمْ يَظُنُّونَ بِاللَّهِ غَيْرَ  
الْحَقِّ ظَنَّ الْجَاهِلِيَّةِ ۗ يَقُولُونَ هَل لَّنَا  
مِنَ الْأَمْرِ مِنْ شَيْءٍ ۗ قُلْ إِنَّ الْأَمْرَ كُلَّهُ  
لِلَّهِ ۗ يُخْفُونَ فِي أَنفُسِهِم مَّا لَا يُبْدُونَ  
لَكَ ۗ يَقُولُونَ لَوْ كَان لَنَا مِنَ الْأَمْرِ  
شَيْءٌ مَّا قُتِلْنَا هَاهُنَا ۗ قُلْ لَوْ كُنْتُمْ فِي  
بُيُوتِكُمْ لَبَرَزَ الَّذِينَ كُتِبَ عَلَيْهِمُ الْقَتْلُ  
إِلَىٰ مَضَاجِعِهِمْ ۗ وَلِيَبْتَلِيَ اللَّهُ مَا فِي  
صُدُورِكُمْ وَلِيُمَحِّصَ مَا فِي قُلُوبِكُمْ ۗ  
وَاللَّهُ عَلِيمٌ بِذَاتِ الصُّدُورِ ﴿٦٠﴾

إِنَّ الَّذِينَ تَوَلَّوْا مِنْكُمْ يَوْمَ الْتَقَى  
الْجَمْعَيْنِ ۗ إِنَّمَا اسْتَزَلَّهُمُ الشَّيْطَانُ بِبَعْضِ  
مَا كَسَبُوا ۗ وَلَقَدْ عَفَا اللَّهُ عَنْهُمْ ۗ إِنَّ اللَّهَ  
غَفُورٌ حَلِيمٌ ﴿٦١﴾

157. O ju që besuat! Mos u bëni si ata që mohuan dhe (që) vëllezërve të tyre, të cilët kur udhëtuan në tokë ose dolën për luftë, u thanë: “Po të rrinit me ne, nuk do të vdisnit dhe nuk do të vriteshit”. (Po u jepet afat) që Allahu të shkaktojë pikëllim në zemrat e tyre. Allahu jep jetë dhe vdekje dhe Allahu i sheh mirë punët tuaja.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَكُونُوا كَالَّذِينَ كَفَرُوا وَقَالُوا لِإِخْوَانِهِمْ إِذَا ضَرَبُوا فِي الْأَرْضِ أَوْ كَانُوا غُرَىٰ نَوْ كَانُوا عِنْدَنَا مَا مَاتُوا وَمَا قُتِلُوا<sup>٣٧</sup> لِيَجْعَلَ اللَّهُ ذَٰلِكَ حَسْرَةً فِي قُلُوبِهِمْ<sup>٣٨</sup> وَاللَّهُ يَخِي وَيُمِيتُ<sup>٣٩</sup> وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ بَصِيرٌ<sup>٤٠</sup>

158. Nëse vriteni ose vdisni në rrugën e Allahut, falja prej Allahut dhe mëshira, pa dyshim, do të jenë shumë më të mira sesa ajo që grumbulloni.

وَلَيْن قُتِلْتُمْ فِي سَبِيلِ اللَّهِ أَوْ مُتُّمْ لَمَغْفِرَةٌ مِّنَ اللَّهِ وَرَحْمَةٌ خَيْرٌ مِّمَّا يَجْمَعُونَ<sup>٤١</sup>

159. E nëse vdisni ose vriteni, tek Allahu do të grumbulloheni.

وَلَيْن مُتُّمْ أَوْ قُتِلْتُمْ لَإِلَى اللَّهِ تُحْشَرُونَ<sup>٤٢</sup>

160. Për shkak të mëshirës nga Allahu, je bërë i butë për ta. Po të ishe i vrazhdë, zemërgur, ata do të largoheshin prej teje. Andaj, fali dhe kërko falje për ta dhe këshillohu me ta në çështjet. E kur të vendosësh, mbështetu tek Allahu. Sigurisht, Allahu i do ata që mbështeten (tek Ai).<sup>38</sup>

فَبِمَا رَحْمَةٍ مِّنَ اللَّهِ لِنْتَ لَهُمْ<sup>٤٣</sup> وَلَوْ كُنْتَ فَظًّا غَلِيظَ الْقَلْبِ لَانْفَضُّوا مِنْ حَوْلِكَ<sup>٤٤</sup> فَاعْفُ عَنْهُمْ وَاسْتَغْفِرْ لَهُمْ وَ شَاوِرْهُمْ فِي الْأَمْرِ<sup>٤٥</sup> فَإِذَا عَزَمْتَ فَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ<sup>٤٦</sup> إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُتَوَكِّلِينَ<sup>٤٧</sup>

38. Ky ajet, së pari, tregon shumë qartë se Profeti Muhammed<sup>savs</sup> ka qenë shumë zemërbutë, siç pohohet edhe në një ajet tjetër: “*ai është shumë i dhembshur dhe mëshirëbërës ndaj besimtarëve*” (Et-Teube 9:128) dhe, së dyti, deklaroi se sahabët<sup>ra</sup> nuk ishin mbledhur rreth Profetit për interes. Zoti pohon se Profeti Muhammed<sup>savs</sup> edhe sikur të shpenzonte gjithë pasurinë e botës, nuk mund t'i grumbullonte ata në këtë mënyrë. Gjithashtu, ajeti e porosit Profetin që të këshillohet me sahabët në çështjet e rëndësishme, megjithatë, vendimin duhet ta marrë ai, pa qenë i kushtëzuar për ta pranuar këshillën e dhënë. E kur të marrë vendimin, të mbështetet vetëm tek Allahu, sepse Ai do të jetë Ndihmësi i tij.

161. Nëse Allahu ju ndihmon, askush nuk mund t'ju mundë, e nëse Ai ju lë pa përkrahje, kush mund t'ju ndihmojë pas Tij?! Tek Allahu duhet të mbështeten besimtarët.

إِنْ يَنْصُرْكُمُ اللَّهُ فَلَا غَالِبَ لَكُمْ ۖ وَإِنْ  
يَخْذُلْكُمْ فَمَنْ ذَا الَّذِي يَنْصُرْكُمْ مِنْ  
بَعْدِهِ ۗ وَعَلَى اللَّهِ فَلْيَتَوَكَّلِ الْمُؤْمِنُونَ ﴿١٦١﴾

162. Nuk është e mundur për një profet të bëjë pandershmëri.<sup>39</sup> E kushdo që bën pandershmëri, do ta sjellë pandershmërinë e vet Ditën e Kiametit. Pastaj, çdo shpirti do t'i kthehet e gjitha ajo që ka punuar dhe nuk do t'i bëhet padrejtësi.

وَمَا كَانَ لِنَبِيٍّ أَنْ يَغُلَّ ۗ وَمَنْ يَغْلُلْ  
يَأْتِ بِمَا غَلَّ يَوْمَ الْقِيَامَةِ ۖ ثُمَّ تُوَلَّى كُلُّ  
نَفْسٍ مَّا كَسَبَتْ وَهُمْ لَا يُظْلَمُونَ ﴿١٦٢﴾

163. Ai që ndjek pëlqimin e Allahut, a mund të jetë si ai që kthehet (mbrapsht) me zemërimin e Tij dhe si strehë e ka xhehenemin?! Sa strehë e keqe është ai!

أَفَمَنْ اتَّبَعَ رِضْوَانَ اللَّهِ كَمَنْ بَاءَ  
بِسَخَطِ مِنَ اللَّهِ وَمَا لَهُ جَهَنَّمَ  
وَيَسَّ الْمَصِيرُ ﴿١٦٣﴾

164. Ata janë (në) grada të ndryshme tek Allahu. Dhe Allahu sheh mirë gjithçka që bëjnë ata.

هُمُ دَرَجَاتٍ عِنْدَ اللَّهِ ۗ وَاللَّهُ بِصِرِّهِمْ  
يَعْمَلُونَ ﴿١٦٤﴾

165. Sigurisht, Allahu u bëri mirësi besimtarëve kur ngriti midis tyre një të Dërguar nga gjiri i tyre; (që) ua reciton ajetet e Tij, i pastron dhe ua mëson Librin dhe urtësinë, kurse ata, deri më parë, ishin në humbje të qartë.

لَقَدْ مَنَّ اللَّهُ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ إِذْ بَعَثَ  
فِيهِمْ رَسُولًا مِّنْ أَنفُسِهِمْ يَتْلُوا عَلَيْهِمْ  
آيَاتِهِ وَيُزَكِّيهِمْ وَيُعَلِّمُهُمُ الْكِتَابَ  
وَالْحِكْمَةَ ۗ وَإِنْ كَانُوا مِنْ قَبْلُ لِنَفَىٰ صَلِيلٍ  
مُّبِينٍ ﴿١٦٥﴾

39. Duke iu përgjigjur akuzave të hipokritëve dhe të mohuesve, Zoti i Madhërisëm edhe mund t'u përgjigjej se Profeti Muhammed<sup>savs</sup> nuk bëri pandershmëri në çështjen në fjalë. Por Ai tha – Nuk është e mundur për ndonjë profet të tregohet i pandershmë. Kjo tregon se në sytë e Zotit niveli shpirtëror i Profetëve dhe ai i njerëzve të zakonshëm nuk janë të barabarta. Zoti nuk zgjedh si profet dikë që ka qoftë një grimë pandershmërie në shpirt. Ky ajet flet vetëm për pandershmërinë sepse kjo akuzë ishte ngritur kundër Profetit<sup>savs</sup> nga ana e kundërshtarëve, por në të vërtetë, Profetët e Zotit nuk kanë as ndonjë ligësi tjetër. Kështu, Kurani e hedh poshtë mendimin e atyre të krishterëve që përshkruajnë Profetë të ndryshëm me ligësi të ndryshme. Lexoni edhe 24:36.

166. Çdo herë kur ju godet ndonjë vështirësi, dyfishin e së cilës ju i keni shkaktuar (armikut), a do të thoni, vallë: “Nga na erdhi kjo?!” Thuaju: “Kjo ju ka ardhur nga vetja juaj”. Pa dyshim, Allahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë.

167. Dhe vështirësia që ju ka goditur ditën kur u ndeshën dy ushtritë, ishte me urdhrin e Allahut, që Ai t’i dallojë besimtarët,

168. e t’i provojë edhe hipokritët. Kur atyre u thanë: “Ejani dhe luftoni në rrugën e Allahut ose të bëni mbrojtje!”, ata thanë: “Po të dinim si të luftojmë, patjetër që do t’ju ndiqnim”. Atë ditë ata ishin më afër mohimit sesa besimit. Ata thonë nga gojët e tyre një gjë që nuk e kanë zemrat e tyre. Allahu e di më së miri çfarë fshehin ata.

169. Ata mbetën, kurse për vëllezërit e vet, thanë: “Po të na dëgjonin ne, nuk do të vriteshin”. Thuaju: “Largojeni vdekjen nga vetja, nëse thoni të vërtetën!”

170. Dhe ata që vriten në rrugën e Allahut, asnjëherë mos i kujto të vdekur. Përkundrazi, janë të gjallë, ushqehen te Zoti i tyre.

171. Janë të hareshëm për atë që Allahu ua ka dhënë nga bekimi i Tij dhe marrin lajme të mira për ata që janë mbrapa tyre, që ende nuk

أَوْ لَمَّا أَصَابَكُمْ مُصِيبَةٌ فَمَا أَصَابَكُمْ مِثْلَهَا قُلْتُمْ أَلَيْ هَذَا قُلْ هُوَ مِنْ عِنْدِ أَنْفُسِكُمْ إِنَّ اللَّهَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿١٦٦﴾

وَمَا أَصَابَكُمْ يَوْمَ التَّتَيِّ الْجَمْعِ فَيَاذَنَ اللَّهُ وَلِيَعْلَمَ الْمُؤْمِنِينَ ﴿١٦٧﴾

وَلِيَعْلَمَ الَّذِينَ نَافَقُوا وَقِيلَ لَهُمْ تَعَالَوْا قَاتِلُوا فِي سَبِيلِ اللَّهِ أَوْ ادْفَعُوا قَالُوا لَوْ نَعْلَمُ قِتَالًا لَأَتَّبَعْنَاكُمْ هُمْ لِلْكَفَرِ يَوْمِيذٍ أَقْرَبُ مِنْهُمْ لِلْإِيمَانِ يَقُولُونَ بِأَفْوَاهِهِمْ مَا لَيْسَ فِي قُلُوبِهِمْ وَاللَّهُ أَعْلَمُ بِمَا يَكْتُمُونَ ﴿١٦٨﴾

الَّذِينَ قَالُوا لِإِخْوَانِهِمْ وَقَعَدُوا لَوْ أَطَاعُونَا مَا قَاتَلُوا قُلْ فَادْرَأُوا عَنْ أَنْفُسِكُمُ الْمَوْتَ إِنْ كُنْتُمْ صَادِقِينَ ﴿١٦٩﴾

وَلَا تَحْسَبَنَّ الَّذِينَ قَاتَلُوا فِي سَبِيلِ اللَّهِ أَمْوَاتًا بَلْ أَحْيَاءٌ عِنْدَ رَبِّهِمْ يُرْزَقُونَ ﴿١٧٠﴾

فَرِحِينَ بِمَا أَنَّهُمُ اللَّهُ مِنْ فَضْلِهِ وَيَسْتَبْشِرُونَ بِالَّذِينَ لَمْ يَلْحَقُوا بِهِمْ مِنْ

u janë bashkuar, që (edhe) ata nuk do të kenë asnjë frikë e as nuk do të pikëllohen.

خَافِهِمْ ۙ أَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ  
يَحْزَنُونَ ﴿٧٧﴾

172. Marrin lajme të mira për mirësinë dhe bekimin e Allahut dhe, (gjithashtu), që Allahu nuk do t'ua humbë shpërblimin besimtarëve.

يَسْتَبْشِرُونَ بِنِعْمَةٍ مِّنَ اللَّهِ وَفَضْلٍ ۙ  
بِئْسَ الْوَعْدَ ۗ إِنَّ اللَّهَ لَا يُضِيعُ أَجْرَ الْمُؤْمِنِينَ ﴿٧٨﴾

173. Ata që iu përgjigjën me pohim Allahut dhe të Dërguarit, pasi që kishin marrë plagë, (dhe) prej tyre që janë mirëbërës dhe patën druajtje (ndaj Zotit), kanë shpërblim të madh.

الَّذِينَ اسْتَجَابُوا لِلَّهِ وَالرَّسُولِ مِنْ بَعْدِ  
مَا أَصَابَهُمُ الْقَرْحُ ۚ لِلَّذِينَ أَحْسَنُوا مِنْهُمْ  
وَاتَّقُوا أَجْرٌ عَظِيمٌ ﴿٧٩﴾

174. Janë ata, të cilëve njerëzit u thanë: “Përnjëmend njerëzit janë bashkuar kundër jush, pra, frikësojuni atyre!”, kjo pikërisht i shtoi në besim dhe ata thanë: “Na mjafton Allahu! Sa Mbrojtës i mirë është Ai!”<sup>40</sup>

الَّذِينَ قَالُوا لَهُمُ النَّاسُ إِنَّ النَّاسَ قَدْ  
جَمَعُوا لَكُمْ فَاخْشَوْهُمْ فَزَادَهُمْ إِيمَانًا ۗ  
وَقَالُوا حَسْبُنَا اللَّهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ ﴿٨٠﴾

175. Prandaj, ata u kthyen me mirësinë dhe bekimin prej Allahut (dhe) asnjë shqetësim nuk i preku. Ata e ndoqën pëlqimin e Allahut dhe Allahu ka bekim të madh.

فَانْقَلَبُوا بِنِعْمَةٍ مِّنَ اللَّهِ وَفَضْلٍ لَّمْ  
يَمْسَسْهُمْ سُوءٌ ۙ وَاتَّبَعُوا رِضْوَانَ اللَّهِ ۗ  
وَاللَّهُ ذُو فَضْلٍ عَظِيمٍ ﴿٨١﴾

176. Në të vërtetë, është djalli që i frikëson shokët e tij, andaj, mos u

إِنَّمَا ذِكْمُ الشَّيْطَانِ يُخَوِّفُ أَوْلِيَاءَهُ ۗ

40. Diku tjetër në Kuran, Zoti thotë: “mirësia është e atyre ... që janë të durueshëm gjatë vështirësive, brengave dhe gjatë luftës” (2:178) “... dhe ata që durojnë duke kërkuar pëlqimin e Zotit të tyre” (13:23). Këto ajete na mësojnë se trimëria e vërtetë i ka rrënjët te durimi dhe te qëndrueshmëria. Trimëria është që të tregohesh i paluhatshëm e të mos ia mbathësh si frikacak përballë tundimeve të shpirtit a vështirësive, të cilat të sulmojnë si armik. Pra, ka dallim të madh midis trimërisë njerëzore dhe asaj kafshore. Kafshët shfaqin egërsinë instinktive, por njeriu që zotëron trimërinë e vërtetë, zgjedh atë që është më afër arsyes dhe pëlqimit të Zotit, përballjen ose heqjen dorë nga përballja.

frikësoni prej tyre, por frikësohuni prej Meje, nëse jeni besimtarë.<sup>41</sup>

177. Të mos shqetësojnë ty ata që përparojnë në mohim. Ata asnjë grimë nuk mund ta dëmtojnë Allahun. Allahu dëshiron që ata të mos kenë asnjë pjesë në *ahiret*, dhe ata do të kenë ndëshkim të madh.

178. Pa dyshim, ata që kanë “blerë” mohimin në këmbim të besimit, aspak nuk mund ta dëmtojnë dot Allahun dhe ata do të kenë ndëshkim të dhimbshëm.

179. Mohuesit të mos mendojnë se, lëshimi që Ne ua kemi dhënë, është mirë për ta. Ne i kemi lëshuar që ata të shtohen në mëkate dhe ata do të kenë ndëshkim poshtërues.

180. Allahu nuk është i tillë që t’ju lërë ju besimtarët në gjendje që jeni, pa e dalluar të ndytin nga i pastri. Dhe nuk është praktikë e Allahut që t’ju njoftojë (të gjithë) ju për të padukshmen, por Allahu zgjedh kë të dojë prej të Dërguarve të Tij. Prandaj, besoni në Allah dhe (në) të

فَلَا تَخَافُوهُمْ وَ خَافُونَ إِنْ كُنْتُمْ  
مُؤْمِنِينَ ﴿٧٧﴾

وَلَا يَحْزُنُكَ الَّذِينَ يُسَارِعُونَ فِي الْكُفْرِ ۗ  
إِنَّهُمْ لَنْ يَصُرُوا اللَّهَ سِيَّئًا يُرِيدُ اللَّهُ  
أَلَّا يَجْعَلَ لَهُمْ حَظًّا فِي الْآخِرَةِ ۗ وَ لَهُمْ  
عَذَابٌ عَظِيمٌ ﴿٧٨﴾

إِنَّ الَّذِينَ اشْتَرُوا الْكُفْرَ بِالْإِيمَانِ لَنْ  
يَصُرُوا اللَّهَ سِيَّئًا ۗ وَ لَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿٧٩﴾

وَلَا يَحْسَبَنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا أَنَّمَا نُمَلِّئُ  
لَهُمْ خَيْرٌ حَيْثُ لَا يَنْفُسُهُمْ ۗ إِنَّمَا نُمَلِّئُهُمْ  
لِيُزَادُوا إِثْمًا ۗ وَ لَهُمْ عَذَابٌ مُهِينٌ ﴿٨٠﴾

مَا كَانَ اللَّهُ لِيَذَرَ الْمُؤْمِنِينَ عَلَى مَا  
أَنْتُمْ عَلَيْهِ حَتَّى يَمِيزَ الْخَبِيثَ مِنَ  
الطَّيِّبِ ۗ وَ مَا كَانَ اللَّهُ لِيُظْلِعَكُمْ  
عَلَى الْغَيْبِ وَلَكِنَّ اللَّهَ يَجْتَبِي مِنْ رُسُلِهِ  
مَنْ يَشَاءُ ۗ فَآمِنُوا بِاللَّهِ وَرُسُلِهِ ۗ وَ إِنْ

41. Djalli ngjall frikë në zemrat e shokëve të tij. Atij që bëhet shok i djallit, duke e lënë miqësinë me Zotin, djalli i ndjell mendime negative. Për shembull, kur vjen koha për të shpenzuar në rrugën e Zotit, i thotë – Mos shpenzo se do të të sosen paratë, dhe mbase nuk do t’i gjesh dot më ato. Ai që ka pranuar shoqërinë e djallit nuk kupton që nuk ishte djalli që i siguroi pasurinë dhe të mirat materiale për herë të parë, përkundrazi, Zoti ia kishte siguruar edhe mjetet, edhe mundësitë, edhe pasurinë. Po kështu, atij që gëzon sukses në politikë dhe fiton pushtet, djalli e frikëson – Po bëre drejtësinë, do ta humbasësh pushtetin! Djalli i kërkton të bëjë padrejtësi ndaj një shtrese a grupi të caktuar, se përndryshe, do ta humbë pushtetin. Kurani pohon se Zoti i dha liri djallit deri në kiamet, kjo do të thotë se deri në kiamet, ai do të vazhdojë të gjejë shokë të tij, të cilët do të vazhdojë t’i frikësojë.



Dërguarit e Tij. Dhe po besuat dhe patët druajtje, do të keni shpërblim madhor.

181. Ata që tregohen koprracë në ato që Allahu ua ka dhënë nga bekimi i Tij, të mos mendojnë se kjo është mirë për ta. Përkundrazi, është e keqe për ta. Ditën e kiametit, patjetër do t'u bjerë në qafë e gjithë koprracia e tyre. E Allahut është trashëgimia e qiejve dhe e tokës dhe Allahu është i Gjithinformuar për atë që bëni ju.

182. Sigurisht, Allahu e ka dëgjuar fjalën e atyre që thanë: “Allahu është i varfër e ne jemi të pasur”. Pa dyshim, Ne do ta shënojmë atë që thanë ata, si dhe kundërshtimin e tyre të ashpër ndaj Profetëve (që ata bënin) pa asnjë të drejtë, dhe do t'u themi: “Shijojeni ndëshkimin zhuritës!

183. Kjo është për shkak të asaj që duart tuaja kanë çuar përpara, kurse Allahu përnjëmend nuk u bën aspak padrejtësi robërve (të Tij).”

184. Atyre që thanë: “Allahu lidhi besë me ne që të mos besojmë asnjë të Dërguar, derisa ai nuk do të na sjellë kurbanin, të cilin e ha zjarri”,<sup>42</sup> thuaju: “edhe para meje ju erdhën të Dërguar me shenja të qarta, si dhe me atë që po thoni ju, atëherë pse i vratë ata,<sup>43</sup> nëse thoni të vërtetën?”

تُؤْمِنُوا وَتَتَّقُوا فَلَكُمْ أَجْرٌ عَظِيمٌ ﴿١٨١﴾

وَلَا يَحْسَبَنَّ الَّذِينَ يَبْخُلُونَ بِمَا أَنهَمُ  
اللَّهُ مِنْ فَضْلِهِ هُوَ حَيْرًا لَّهُمْ ۗ بَلْ هُوَ  
شَرٌّ لَّهُمْ ۗ سَيُطَوَّقُونَ مَا بَخُلُوا بِهِ يَوْمَ  
الْقِيَامَةِ ۗ وَاللَّهُ مِيرَاثُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ۗ  
وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرٌ ﴿١٨٢﴾

لَقَدْ سَمِعَ اللَّهُ قَوْلَ الَّذِينَ قَالُوا إِنَّ اللَّهَ  
فَقِيرٌ وَنَحْنُ أَغْنِيَاءُ سَكَتَبْ مَا قَالُوا  
وَقَتَلَهُمُ الْآتِيَاءُ بغيرِ حَقٍّ ۗ وَتَقُولُ ذُوقُوا  
عَذَابَ الْحَرِيقِ ﴿١٨٣﴾

ذَلِكَ بِمَا قَدَّمْت أَيْدِيكُمْ وَأَنَّ اللَّهَ لَيْسَ  
بِظَلَّامٍ لِّلْعَبِيدِ ﴿١٨٤﴾

الَّذِينَ قَالُوا إِنَّ اللَّهَ عَهِدَ إِلَيْنَا أَلاَّ  
نُؤْمِنَ لِرَسُولٍ حَتَّىٰ يَأْتِينَا بِقُرْبَانٍ تَأْكُلُهُ  
النَّارُ ۗ قُلْ قَدْ جَاءَكُمْ رَسُولٌ مِّن قَبْلِي  
بِالْبَيِّنَاتِ وَالَّذِي قُلْتُمْ فَلِمَ قَتَلْتُمُوهُمْ  
إِنْ كُنْتُمْ صَادِقِينَ ﴿١٨٥﴾

42. Nuk do të thotë se zjarri të vinte nga diku dhe ta shkrumbonte kurbanin, por i referohet një zakoni ku kurbanit thehëj në altar, mbi të cilin vinin zjarr, dhe kjo quhej *fli shkrumbimi*. (Bibla, Levitiku, kap. 1). Flijimi i tillë praktikohëj shpesh te hindutë, persët dhe hebrenjtë.

43. Lexoni 3:113.

185. Nëse të quajnë gënjeshtar, (dije se) edhe para teje janë quajtur gënjeshtarë të Dërguar (të tjerë), të cilët kishin sjellë shenjat e qarta, shkrimet (Hyjnore) dhe Librin dritëplotë.

فَإِنْ كَذَّبُوكَ فَقَدْ كَذَّبَ رَسُولٌ مِّنْ قَبْلِكَ جَاءُوا بِبَيِّنَاتٍ وَالزُّبُرِ وَالْكِتَابِ الْمُنِيرِ ﴿١٨٥﴾

186. Çdo shpirt do të shijojë vdekjen. Ditën e kiametit juve do t'ju jepen shpërblimet tuaja të plota. Ai që u mbajti larg zjarrit dhe u fut në xhenet, e ka arritur suksesin. Dhe jeta e kësaj bote nuk është gjë tjetër, veçse një përfitim mashtrues.

كُلُّ نَفْسٍ ذَائِقَةُ الْمَوْتِ وَإِنَّمَا تُوَفَّقُونَ أَجُورَكُمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ فَمَنْ زُحِرَ عَنِ النَّارِ وَأُدْخِلَ الْجَنَّةَ فَقَدْ فَازَ وَمَا الْحَيَاةُ الدُّنْيَا إِلَّا مَتَاعُ الْغُرُورِ ﴿١٨٦﴾

187. Ju patjetër do të sprovoheni me pasuritë tuaja dhe me jetën tuaj dhe do të dëgjoni shumë fjalë therëse nga ata, të cilëve u ishte dhënë Libri para jush dhe nga ata që janë idhujtarë. Po duruat dhe patët druajtje (ndaj Zotit), kjo përnjëmend do të jetë një prej veprave shumë të guximshme.<sup>44</sup>

لَتُبْلَوْنَ فِيْ أَمْوَالِكُمْ وَأَنْفُسِكُمْ وَلَتَسْمَعَنَّ مِنَ الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ مِنْ قَبْلِكُمْ وَمِنَ الَّذِينَ أَشْرَكُوا أَذًى كَثِيرًا وَإِنْ تَصْبِرُوا وَتَتَّقُوا فَإِنَّ ذَلِكَ مِنْ عَزْمِ الْأُمُورِ ﴿١٨٧﴾

188. E kur Allahu mori besëlidhjen me ata që u ishte dhënë Libri: “Ju do ta shpjegoni atë qartazi për njerëzit dhe nuk do ta fshihni!”, ata e hodhën pas shpine dhe morën një çmim të ulët në këmbim të saj. Çfarë këmbimi të keq bëjnë ata!

وَإِذْ أَخَذَ اللَّهُ مِيثَاقَ الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ لَتُبَيِّنُنَّهُ لِلنَّاسِ وَلَا تَكْفُمُونَهُ فَنَبَذُوهُ وَرَاءَ ظُهُورِهِمْ وَاشْتَرَوْا بِهِ ثَمَنًا قَلِيلًا فَبَيَّسَ مَا يَشْتَرُونَ ﴿١٨٨﴾

189. Mos mendo dhe kurrë mos mendo se do të shpëtojnë nga

لَا تَحْسَبَنَّ الَّذِينَ يَفْرَحُونَ بِمَا أُوتُوا وَيُحِبُّونَ أَنْ يُحْمَدُوا بِمَا لَمْ يَفْعَلُوا فَلَا

44. Realisht, ky ajet përmban një profeci për një kohë, kur njerëzit do të kishin lirinë fetare deri në atë masë që do të mund të shanin udhëheqësit fetarë si të donin, siç është edhe koha jonë sot. Zoti i Madhërishëm i porosit muslimanët që në atë kohë ta zbatonin këtë porosi. Kurani nuk ka asnjë ajet ku i porosit muslimanët të marrin armë kundër blasfemuesit, përkundrazi, në këtë ajet, i porosit që kur dikush ua lëndon zemrën duke përdorur fjalë fyese, të tregojnë durim, dhe kjo do t'u quhet një vepër e guximshme.

ndëshkimi ata që gëzohen në punët e tyre dhe dëshirojnë të lëvdohen për diçka që nuk kanë bërë. Ata do të kenë ndëshkim të dhimbshëm.

190. I Allahut është sundimi i qiejve dhe i tokës dhe Allahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë.

191. Pa dyshim, në krijimin e qiejve dhe të tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për të mençurit.

192. Ata që kujtojnë Allahun në këmbë, ulur dhe kur janë (shtrirë) në ijët e tyre dhe thellohen në krijimin e qiejve dhe të tokës: “O Zoti ynë! Këto nuk i ke krijuar kot! Ti je i Shenjtë. Andaj, na shpëto nga ndëshkimi i zjarrit!”<sup>45</sup>

193. O Zoti ynë! Këdo që e fut në zjarr, e ke poshtëruar. Dhe keqberësit nuk do të kenë asnjë ndihmës.

194. O Zoti ynë! Ne sigurisht kemi dëgjuar një lajmëtar, i cili na thërret drejt besimit (duke thënë): “Besoni në Zotin tuaj!” Dhe ne besuam. Prandaj, o Zoti ynë, fali gjynahet tona, zhduki ligësitë tona dhe na jep vdekje me të mirët.

195. O Zoti ynë! Na jep edhe atë që ke premtuar për ne te të Dërguarit e Tu dhe mos na poshtëro në Ditën e Kiametit! Ti pa dyshim nuk e shkel premtimin”.

تَحْسَبُهُمْ بِمَفَازَةٍ مِّنَ الْعَذَابِ ۗ وَهُمْ  
عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿١٩٠﴾

وَاللَّهُ مُلْكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ۗ وَاللَّهُ  
بِغَيْبِ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿١٩١﴾

إِنَّ فِي خَلْقِ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَاخْتِلَافِ  
الْأَيِّلِ وَالنَّهَارِ لَآيَاتٍ لِّأُولِي الْأَبْصَارِ ﴿١٩٢﴾

الَّذِينَ يَذْكُرُونَ اللَّهَ قِيَمًا وَفُوعًا وَعَلَى  
جُوبِهِمْ وَيَتَفَكَّرُونَ فِي خَلْقِ السَّمَوَاتِ  
وَالْأَرْضِ ۗ رَبَّنَا مَا خَلَقْتَ هَذَا بَاطِلًا  
سُبْحَانَكَ فَقِنَا عَذَابَ النَّارِ ﴿١٩٣﴾

رَبَّنَا إِنَّكَ مَن تُدْخِلِ النَّارَ فَقَدْ  
أَخْرَيْتَهُ ۗ وَمَا لِلظَّالِمِينَ مِنْ أَنْصَارٍ ﴿١٩٤﴾

رَبَّنَا إِنَّا سَمِعْنَا مُنَادِيًا يُنَادِي لِلْإِيمَانِ  
أَن آمِنُوا بِرَبِّكُمْ فَآمَنَّا ۗ رَبَّنَا فَاغْفِرْ لَنَا  
ذُنُوبَنَا وَكَفِّرْ عَنَّا سَيِّئَاتِنَا وَتَوَقَّنَا مَعَ  
الْأَبْرَارِ ﴿١٩٥﴾

رَبَّنَا وَآتِنَا مَا وَعَدْتَنَا عَلَى رُسُلِكَ  
وَلَا تُخْزِنَا يَوْمَ الْقِيَامَةِ ۗ إِنَّكَ لَا تُخْلِفُ  
الْمِيعَادَ ﴿١٩٦﴾

45. Besimtarët e vërtetë janë ata që kur studiojnë universin, nuk tregohen si adhuresit e materies duke u mjaftuar me nxjerrjen e të dhënave të saj, por pasi e shohin përsosmërinë në krijim, kërkojnë edhe dorën e Krijuesit dhe e forcojnë besimin e tyre.

196. Ndaj, Zoti i tyre ua pranoi (lutjen dhe tha): Sigurisht, nuk do ta humb veprën e asnjë vepruesi prej jush, qoftë burrë a grua. Disa prej jush kanë lidhje me disa të tjerë. Prandaj, ata që mërguan nga vatrat e tyre dhe janë lënduar në rrugën Time, që luftuan dhe që u vranë, Unë, pa dyshim, do t'ua zhduk mëkatet e tyre dhe do t'i çoj në kopshte, në të cilat rrjedhin lumenj, si shpërblim prej Allahut. Tek Allahu është shpërblimi më i mirë.

فَاسْتَجَابَ لَهُمْ رَبُّهُمْ أَنِّي لَا أُضِيعُ عَمَلَ  
عَامِلٍ مِّنْكُمْ مِّمَّنْ ذَكَرَ وَأُنثَىٰ بَعْضُكُمْ  
مِّنْ بَعْضٍ ۚ فَأَلَّذِينَ هَاجَرُوا وَأَخْرَجُوا  
مِن دِيَارِهِمْ وَأُودُوا فِي سَبِيلِي وَقَتَلُوا  
وَقُتِلُوا لَا كُفْرَانَ عَنْهُمْ سَيِّئَاتِهِمْ وَ  
لَا دُخْلَٰنَهُمْ جَنَّةٍ تَجْرَىٰ مِنْ تَحْتِهَا  
الْأَنْهَارُ ۚ ثَوَابًا مِّنْ عِنْدِ اللَّهِ ۗ وَاللَّهُ عِنْدَهُ  
حُسْنُ الثَّوَابِ ﴿١٩٦﴾

197. Le të mos mashtrojë ty bredhja e mohuesve nëpër vende (të ndryshme).

لَا يَعْزُبُكَ تَقَلُّبُ الَّذِينَ كَفَرُوا فِي  
الْبِلَادِ ﴿١٩٧﴾

198. Është një përfitim i shkurtër! Pastaj, vendqëndrimi i tyre do të jetë xhehenemi. Sa shtrat i keq është ai!

مَتَاعٌ قَلِيلٌ ۖ ثُمَّ مَأْوَاهُمْ جَهَنَّمُ  
وَبِئْسَ الْمِهَادُ ﴿١٩٨﴾

199. Kurse ata që iu druajtën Zotit të tyre, do të kenë kopshte në të cilat rrjedhin lumenj, ku do të jetojnë përgjithmonë, si mikpritje prej Allahut. Është shumë e mirë ajo që është tek Allahu për të mirët.

لٰكِنَ الَّذِينَ اتَّقَوْا رَبَّهُمْ لَهُمْ جَنَّاتٌ  
تَجْرَىٰ مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا  
نُزُلًا مِّنْ عِنْدِ اللَّهِ ۗ وَمَا عِنْدَ اللَّهِ خَيْرٌ  
لِّلْأَبْرَارِ ﴿١٩٩﴾

200. Sigurisht, nga ithtarët e Librit ka edhe të tillë që besojnë Allahun dhe atë që ju është zbritur juve si dhe atë që u është zbritur atyre, duke iu përlur Allahut. Ata nuk i këmbëjnë ajetet e Allahut me çmim të ulët. Këta do të kenë shpërblimin e tyre te Zoti i tyre. Allahu, pa dyshim, është i shpejtë në llogari.

وَإِنَّ مِنْ أَهْلِ الْكِتَابِ لَمَنْ يُؤْمِنُ  
بِاللَّهِ وَمَا أُنزِلَ إِلَيْكُمْ وَمَا أُنزِلَ إِلَيْهِمْ  
خُشِعِينَ لِلَّهِ لَا يَشْتَرُونَ بِآيَاتِ اللَّهِ ثَمَنًا  
قَلِيلًا ۗ أُولَٰئِكَ لَهُمْ أَجْرُهُمْ عِنْدَ رَبِّهِمْ ۗ  
إِنَّ اللَّهَ سَرِيعُ الْحِسَابِ ﴿٢٠٠﴾

201. O ju që besuat! Duroni, këshilloni për durimin, qëndroni duke i ruajtur kufijtë dhe kijeni druajtjen ndaj Allahut, që të gëzoni sukses!<sup>46</sup>

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اصْبِرُوا وَصَابِرُوا  
وَرَابِطُوا ۗ وَاتَّقُوا اللَّهَ لَعَلَّكُمْ  
تُفْلِحُونَ ﴿٢٠١﴾

46. *Rabitu* vjen nga fjala *ribat* do të thotë të lidhësh kuaj në kufirin pranë tokës së armikut, pra nënkupton kalorësit që qëndrojnë aty. *Ribat* gjithashtu do të thotë të lidhësh e të forcosh zemrën ose shpirtin (Mufredat). Kështu, Zoti i porositi muslimanët të rrinë në gatishmëri të plotë përballë armikut, si armikut të jetës, ashtu edhe atij të shpirtit. Dihet që vetëm ata kuaj hyjnë në punë që janë të trajnuar. Nuk mund të rrih në kufi me çfarëdo kali a mjeti. Po kështu, njeriu duhet ta trajnojë shpirtin e tij në atë mënyrë, që ai të mund t'u nënshtrohet lehtësisht porosive të Zotit, përndryshe, ai nuk mund të ketë sukses në betejën e tij kundër djallit, armikut të tij më të përbetuar, i cili në çdo çast i rri në pritë. Ashtu siç në betejë nuk mjafton vetëm trupi, por të duhet edhe mjeshtëria për të përdorur armët, në të njëjtën mënyrë, edhe besimtari duhet ta trajnojë shpirtin e tij me dije e me metoda praktike duke pasur durim e përkushtim, përndryshe ai nuk mund të ketë sukses në xihadin e tij kundër djallit, madje ka mundësi të poshtërohet prej tij, sepse nëse ke mjetet e duhura për të luftuar, por nuk di t'i përdorësh, shumë shpejt do të dorëzohesh përballë kundërshtarit.

## Surja 4 – En-Nisa

Kjo sure u zbrit midis vitit të tretë dhe të pestë pas *hixhretit*. Bashkë me *bismil-lahin*, ajo ka njëqind e shtatëdhjetë e shtatë ajete.

Që në fillim të saj, kjo sure zbulon një fakt tjetër të emrit Adem, duke pohuar se krijimi i njeriut u realizua mrekullisht me një shpirt të vetëm.

Kjo sure ka lidhje të ngushtë me temën që surja paraardhëse e parashtrroi në mbyllje të saj. Ajeti i fundit i sures Ali Imran porositi për durimin, për këshillimin e njëri-tjetrit për të njëjtën gjë dhe për ruajtjen e kufijve. Kurse në suren En-Nisa përmenden luftëra të përgjakshme me armikun, të cilat, si pasojë do të linin shumë gra të veja dhe fëmijë jetimë. Në këtë rast, për t'u dhënë të drejta fëmijëve jetimë dhe të vejave, si një zgjidhje ka ardhur leja e poligamisë, por me kushtin që besimtari të ketë drejtësi mes tyre. E nëse nuk mundet, ai nuk mund të martohet me më shumë se një grua.

Kjo sure parashtron parimet kryesore të sistemit të trashëgimisë në Islam.

Surja En-Nisa përsërit marrëdhëniet midis hebrenjve e të krishterëve si dhe ardhjen e *Hazret Isait*, paqja qoftë mbi të, por në një kontekst të ri. Ajo zbulon se kur hebrenjtë shkelën të gjitha premtimet, u bënë zemërgurë dhe përfundimisht tentuan ta kryqëzonin *Hazret Isain*<sup>as</sup>, atëherë Allahu i Lartësuar e shpëtoi atë, duke i bërë të dështonin përpjekjet e hebrenjve dhe duke e liruar *Hazret Isain*<sup>as</sup> dhe nënën e tij të ndershme nga akuzat e tyre.

Në këtë sure përmendet edhe mërgimi i *Hazret Isait*<sup>as</sup> si dhe profecia që njerëzit prej secilit grup nga ithtarët e Librit, do ta besonin *Hazret Isain*<sup>as</sup> dhe do të pranonin edhe vdekjen e tij të natyrshme. Kjo profeci u përmbush fjalë për fjalë, kur *Hazret Isai*<sup>as</sup> mërgoi në Kashmir përgjatë Afganistanit.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. O njerëz! Kini druajtje ndaj Zotit tuaj që ju krijoi prej një shpirti të vetëm dhe prej tij krijoi çiftin e tij dhe përmes atyre të dyve, përhapi shumë burra e gra. Kini druajtje ndaj Allahut, (në saje të) të cilit ju kërkoni njëri-tjetrin dhe mbani lidhjet farefisnore! Allahu pa dyshim është Mbikëqyrësi juaj.<sup>1</sup>

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَخَلَقَ مِنْهَا زَوْجَهَا وَبَثَّ مِنْهُمَا رِجَالًا كَثِيرًا وَنِسَاءً ۗ وَاتَّقُوا اللَّهَ الَّذِي تَسَاءَلُونَ بِهِ وَالْأَرْحَامَ ۗ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلَيْكُمْ رَقِيبًا ①

3. Jepuni jetimëve pasurinë e tyre dhe mos merrni të ndytën në këmbim të së pastres! Mos hani pasurinë e tyre duke e përzier me pasurinë tuaj! Kjo pa dyshim është mëkat i madh.

وَأْتُوا الْيَتَامَىٰ أَمْوَالَهُمْ وَلَا تَتَبَدَّلُوا الْخَبِيثَ بِالطَّيِّبِ ۚ وَلَا تَأْكُلُوا أَمْوَالَهُمْ إِلَىٰ أَمْوَالِكُمْ ۗ إِنَّهُ كَانَ حُوبًا كَبِيرًا ①

4. Nëse keni frikë se nuk do të bëni dot drejtësinë ndaj jetimeve, martohuni me gra që ju pëlqejnë: me dy, tri e katër. Por nëse keni frikë se nuk do të bëni dot drejtësinë, atëherë veç me një, ose me atë që keni në zotërimin tuaj. Kjo (mënyrë) është

وَإِنْ خِفْتُمْ أَلَّا تُقْسِطُوا فِي الْيَتَامَىٰ فَانكِحُوا مَا طَابَ لَكُمْ مِنَ النِّسَاءِ مَثْنَىٰ وَثُلَاثَ وَرُبْعًا ۚ فَإِنْ خِفْتُمْ أَلَّا تَعْدِلُوا فَوَاحِدَةً أَوْ مَا مَلَكَتْ أَيْمَانُكُمْ ۗ ذَلِكَ

1. Zoti thotë, prej qenies së parë të Ademit, ka krijuar çiftin e tij, që u quajt Hava, në mënyrë që lidhja e tyre me pasardhësit të jetë natyrale dhe biologjike dhe jo artificiale. Ky është edhe themeli i dhembshurisë mes të gjithë njerëzve, sepse lidhjet natyrale janë të pashkëputshme, kurse ato artificiale nuk ruajnë tërheqje ndërmjet njëra-tjetrës. Kështu Allahu i Madhërishtëm e bekoj njeriun edhe me lidhjen me Vetën si Krijues, edhe me lidhjen ndërmjet njerëzve. Megjithatë, këtu duhet sqaruar se kur bëhet fjalë për Ademin si njeriu i parë, ai nuk ishte Ademi që qe para 6 a 7 mijë vitesh. Ademi, Profeti i parë i njerëzimit, njeriu i parë i përsosur shpirtërisht, të cilin Zoti e bekoj me Shpirtin e Shenjtë, është tjetër, kurse krijesa e parë si njeri është tjetër. Për njeriun e kohës para Ademit, Kurani pohon se ai “nuk ishte diçka për t’u përmendur” (76:2). Lexoni 2:31.

më afër që të mos bëni padrejtësi.<sup>2</sup>

5. Jepuni grave dhuratën e tyre martesore me gjithë zemër. Më pas, nëse ato vetë ju japin me dëshirë ndonjë pjesë nga ajo, mund ta hani pa ngurrim.

6. Dhe mos ua dorëzoni të pamendëve pasuritë tuaja, të cilat Allahu i bëri si mjet qëndrueshmërie për ju. Prej tyre ushqejini ata, vishini dhe thojuni fjalë të mira.

7. Vërinë në provë jetimët, derisa të arrijnë moshën e martesës. Nëse ndieni pjekurinë te ta, kthejuani pasurinë e tyre. Mos e hani atë duke e tepruar dhe duke shpejtuar, (nga frika) se mos po rriten. Ai që është i pasur, duhet të përmbahet tërësisht, kurse ai që është i varfër, le të hajë (diçka nga ajo) në mënyrë të drejtë. Kur t'ua ktheni pasurinë atyre, caktoni dëshmitar mbi ta. Dhe Allahu është i mjaftueshëm si Llogaritës.

أَدْنَىٰ أَلَّا تَعُولُوا ۝

وَأْتُوا النِّسَاءَ صَدَقَاتِهِنَّ نِحْلَةً ۖ فَإِنْ  
طِبْنَ لَكُمْ عَنْ شَيْءٍ مِّنْهُ نَفْسًا فَكُلُوهُ  
هَنِيئًا مَّرِيًّا ۝

وَلَا تُؤْتُوا السُّفَهَاءَ أَمْوَالَكُمُ الَّتِي جَعَلَ  
اللَّهُ لَكُمْ قِيَامًا وَارزُقُوهُمْ فِيهَا  
وَأَكْسُوهُمْ وَقُولُوا لَهُمْ قَوْلًا مَعْرُوفًا ۝

وَابْتَلُوا الْيَتَامَىٰ حَتَّىٰ إِذَا بَلَغُوا النِّكَاحَ ۚ فَإِنْ  
أَنْتُمْ مِنْهُمْ رُشَدًا فَادْفَعُوا إِلَيْهِمْ  
أَمْوَالَهُمْ ۚ وَلَا تَأْكُلُوهَا إِسْرَافًا وَبِدَارًا  
أَنْ يَكْبَرُوا ۖ وَمَنْ كَانَ عَنِيًّا فَلْيَسْتَعْفِفْ ۚ  
وَمَنْ كَانَ فَقِيرًا فَلْيَأْكُلْ بِالْمَعْرُوفِ ۖ  
فَإِذَا دَفَعْتُمْ إِلَيْهِمْ أَمْوَالَهُمْ فَأَشْهَدُوا  
عَلَيْهِمْ ۖ وَكَفَىٰ بِاللَّهِ حَسِيبًا ۝

2. Ky ajet nuk ju jep porosinë që patjetër duhet të martoheni me dy, tri ose katër gra, por thotë se maksimumi mund të keni katër gra në një kohë. Më parë, arabët nuk kishin asnjë kufi për sa i përket numrit të grave me të cilat mund të martoheshin. Në këtë kontekst, ky ajet më shumë të kufizon se sa të jep liri për martesën me shumë gra. Së dyti, kjo leje është e lidhur me rrethanat specifike, si ajo e luftës, kur shumë gra mbeten të veja, lind nevoja e sistemimit të grave të palës së pushtuar dhe, gjithashtu, rritja drastike e numrit të jetimëve e kërkon një leje të tillë, pasi një njeri me një grua, nuk mban dot jetimët jashtë kapaciteteve të tij. Në këto rrethana, i është dhënë leje njeriut të martohet me më shumë se një grua, por edhe kjo leje e kushtëzon atë të bëjë drejtësi. Ky ajet, në të dyja skajet e tij, e përmend si kusht drejtësinë. Ata që thjesht duan të përfitojnë nga kjo leje dhe martohen me një grua të dytë, duke e lënë të parën si “të braktisur”, absolutisht nuk veprojnë sipas mësimëve të Islamit, por ndjekin vetëm dëshirat vetjake.



8. Burrat kanë pjesë në atë që kanë prindërit dhe të afërmit. Gjithashtu, edhe gratë kanë pjesë në atë që kanë prindërit dhe të afërmit; qoftë e vogël qoftë e madhe; (kanë) pjesë të caktuar.

9. Gjatë shpërndarjes (së trashëgimisë) nëse vijnë të afërmit (të cilëve, si rregull, nuk u takon ndonjë pjesë), jetimët dhe nevojtarët, jepuni edhe atyre nga ajo dhe flisni fjalë të mira me ta.

10. Ata duhet të frikësohen nga mundësia se do të linin pasardhës të dobët, për të cilët do të brengoseshin. Prandaj, le të kenë druajtje ndaj Allahut dhe të thonë fjalë të drejta.

11. Ata që kanë pasurinë e jetimëve padrejtësisht, në të vërtetë, kanë zjarr në barkun e tyre. Ata patjetër do të hidhen në zjarrin flakëruës.

12. Allahu ju porosit rreth (trashëgimisë së) fëmijëve tuaj: për mashkullin sa pjesa e dy femrave.<sup>3</sup> Nëse ato janë femra më shumë se dy, u takon dy e treta e asaj që (i vdekuri) ka lënë dhe, nëse është vetëm një, asaj i takon gjysma. Dhe prindërit e tij, secilit prej të dyve, i takon një e gjashta e asaj që ai ka lënë, në rast se ka lënë pas fëmijë.

لِلرِّجَالِ نَصِيبٌ مِّمَّا تَرَكَ الْوَالِدَانِ  
وَالْأَقْرَبُونَ ۖ وَلِلنِّسَاءِ نَصِيبٌ مِّمَّا تَرَكَ  
الْوَالِدَانِ وَالْأَقْرَبُونَ مِمَّا قَلَّ مِنْهُ أَوْ كَثُرَ ۗ  
نَصِيبًا مَّفْرُوضًا ۝

وَإِذَا حَضَرَ الْقِسْمَةَ أُولُو الْقُرْبَىٰ وَالْيَتَامَىٰ  
وَالْمَسْكِينُ فَأَرْزُقُوهُمْ مِنْهُ وَقُولُوا لَهُمْ  
قَوْلًا مَعْرُوفًا ۝

وَلِيَخْشَ الَّذِينَ لَوْ تَرَكُوا مِنْ خَلْفِهِمْ  
ذُرِّيَّةً ضِعْفًا خَافُوا عَلَيْهِمْ ۗ فَلْيَتَّقُوا اللَّهَ  
وَلْيَقُولُوا قَوْلًا سَدِيدًا ۝

إِنَّ الَّذِينَ يَأْكُلُونَ أَمْوَالَ الْيَتَامَىٰ ظُلْمًا  
إِنَّمَا يَأْكُلُونَ فِي بُطُونِهِمْ نَارًا ۖ وَسَيَصْلَوْنَ  
سَعِيرًا ۝

يُوصِيكُمُ اللَّهُ فِي أَوْلَادِكُمْ لِلذَّكَرِ مِثْلُ  
حِطِّ الْأُنثِيَّتَيْنِ ۚ فَإِنْ كُنَّ نِسَاءً فَوْقَ  
اثنَيْنِ فَلَهُنَّ ثُلُثًا مِمَّا تَرَكَ ۚ وَإِنْ  
كَانَتْ وَاحِدَةً فَلَهَا النِّصْفُ ۗ وَلِأَبَوَيْهِ  
لِكُلِّ وَاحِدٍ مِّنْهُمَا السُّدُسُ مِمَّا تَرَكَ ۚ إِنْ  
كَانَ لَهُ وَلَدٌ فَإِنْ لَّمْ يَكُنْ لَهُ وَلَدٌ

3. Për mashkullin sa pjesa e dy femrave, sepse vajza merr pjesën tjetër nga ana e bashkëshortit. Pra, ajo merr një pjesë nga prindërit e saj, dhe një tjetër nga prindërit e burrit ose nga vetë burri i saj.

Nëse ai nuk ka ndonjë fëmijë dhe e trashëgojnë prindërit, atëherë një e treta për nënën. Nëse ai ka vëllezër (dhe motra), atëherë një e gjashta për nënën, pasi të paguhet testamenti që ka bërë dhe të shlyhet borxhi. Etërit tuaj a bijtë tuaj, ju nuk dini se kush prej tyre është më i dobishëm për ju. Ky është një caktim prej Allahut. Sigurisht, Allahu është i Gjithëdijshëm, i Urtë.

13. Ju keni gjysmën e asaj që kanë lënë bashkëshortet tuaja, në rast se ato nuk kanë ndonjë fëmijë. Nëse ato kanë ndonjë fëmijë, atëherë ju takon një e katërta e asaj që ato kanë lënë, pasi të paguhet testamenti që ato kanë bërë dhe të shlyhet borxhi. Kurse ato kanë një të katërtën e asaj që ju keni lënë, në rast se nuk keni ndonjë fëmijë. Nëse keni ndonjë fëmijë, atëherë atyre u takon një e teta e asaj që keni lënë, pasi të paguhet testamenti që keni bërë dhe të shlyhet borxhi. Nëse ndahet trashëgimia e një njeriu – qoftë ai burrë apo grua – që është i vetëm (që nuk ka as prindër e as fëmijë), por ka vëlla ose motër, secilit prej tyre i takon një e gjashta. Nëse ata janë më shumë se kaq, atëherë janë pjesëtarë në një të tretën, pasi të paguhet testamenti që ka bërë e të shlyhet borxhi. Askush nuk duhet të vihet në vështirësi. Kjo porosi është nga Allahu dhe Allahu është i Gjithëdijshëm, i Përmbajtur.

14. Këta janë kufijtë (e caktuar) prej Allahut. Ai që i bindet Allahut dhe

وَ وَّرِثَهُ أَبُوهُ فَلِأُمَّهِ الثُّلُثُ ۚ فَإِنْ  
كَانَ لَهُ إِخْوَةٌ فَلِأُمَّهِ السُّدُسُ مِنْ بَعْدِ  
وَصِيَّةٍ يُوصِي بِهَا أَوْدَيْنِ ۗ أَبَاؤُكُمْ  
وَأَبْنَاؤُكُمْ لَا تَدْرُونَ أَيُّهُمْ أَقْرَبُ  
لَكُمْ نَفَعًا ۗ فَرِيضَةٌ مِنَ اللَّهِ ۗ إِنَّ اللَّهَ  
كَانَ عَلِيمًا حَكِيمًا ﴿١٧﴾

وَلَكُمْ نِصْفُ مَا تَرَكَ أَزْوَاجُكُمْ إِنْ لَمْ  
يَكُنْ لِهِنَّ وَكَلَّةٌ ۚ فَإِنْ كَانَ لَهُنَّ وَكَلَّةٌ  
فَلِكُلِّ الرُّبْعِ ۗ مِمَّا تَرَكَنَّ مِنْ بَعْدِ وَصِيَّةٍ  
يُوصِينَ بِهَا أَوْدَيْنِ ۗ وَلِهِنَّ الرُّبْعُ ۗ مِمَّا  
تَرَكَتُمْ إِنْ لَمْ يَكُنْ لَكُمْ وَكَلَّةٌ ۚ فَإِنْ كَانَ  
لَكُمْ وَكَلَّةٌ فَلِهِنَّ الثُّمُنُ ۗ مِمَّا تَرَكَتُمْ مِنْ  
بَعْدِ وَصِيَّةٍ تُوصُونَ بِهَا أَوْدَيْنِ ۗ وَإِنْ  
كَانَ رَجُلٌ يُورِثُ كَلَلَةً أَوْ امْرَأَةً وَوَلَّهُ  
أَخًا أَوْ أُخْتًا فَلِكُلِّ وَاحِدٍ مِمَّهَا السُّدُسُ ۚ  
فَإِنْ كَانُوا أَكْثَرَ مِنْ ذَلِكَ فَهُمْ شُرَكَاءُ  
فِي الثُّلُثِ ۗ مِنْ بَعْدِ وَصِيَّةٍ يُوصِي بِهَا  
أَوْدَيْنِ ۗ غَيْرِ مَصْرَاجٍ ۚ وَصِيَّةٌ مِنَ اللَّهِ  
وَ اللَّهُ عَلِيمٌ حَكِيمٌ ﴿١٧﴾

تِلْكَ حُدُودُ اللَّهِ ۗ وَمَنْ يُطِيعِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ

të Dërguarit të Tij, (Allahu) do ta çojë në xhenet, në të cilin rrjedhin lumenj. Ata do të mbesin gjatë në të dhe ky është sukcesi madhështor.

15. Ai që kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe shkel kufijtë e Tij, (Allahu) do ta fusë në zjarr, ku do të mbetet gjatë dhe ai do të ketë ndëshkim poshtërues.

16. Për ato gra tuajat që bëjnë imoralitet, kërkoni katër dëshmitarë prej jush. Nëse ata dëshmojnë (një gjë të tillë), mbajini ato nëpër shtëpi, derisa t'u vijë vdekja ose t'u hapë Allahu ndonjë rrugë.

17. Dhe nëse dy burra prej jush e bëjnë këtë gjë, ndëshkojini. Nëse ata pendohen dhe përmirësohen, anashkalojini. Sigurisht, Allahu është shumë Pendimpranues, shumë Mëshirëbërës.

18. Në të vërtetë, Allahu u pranon pendesën vetëm atyre që bëjnë keq nga marrëzia e më pas, shumë shpejt, pendohen. Allahu pikërisht këtyre ua pranon pendesën duke i mëshuar. Allahu është i Gjithëdijshëm, i Urtë.

19. Dhe pendesa nuk vlen për ata që bëjnë të këqija, aq sa kur i vjen vdekja ndokujt prej tyre, ai thotë – Tash, me gjithëmend po pendohem – e as për ata që vdesin si mohues. Janë këta për të cilët kemi përgatitur ndëshkim të dhimbshëm.

يُدْخِلُهُ جَنَّتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ  
خَالِدِينَ فِيهَا ذَلِكَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ ﴿١٥﴾

وَمَنْ يَعْصِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَيَتَعَدَّ حُدُودَهُ  
يُدْخِلْهُ نَارًا خَالِدًا فِيهَا وَلَهُ عَذَابٌ  
أَلِيمٌ ﴿١٦﴾

وَالَّذِي يَأْتِيَنَّ الْفَاحِشَةَ مِنْ نِسَائِكُمْ  
فَأْتَسْهَدُوا عَلَيْهِنَّ أَرْبَعَةً مِنْكُمْ ۖ فَإِنْ  
شَهِدُوا فَأَمْسَكُوهُنَّ فِي الْبُيُوتِ حَتَّى  
يَتَوَقَّهِنَّ الْمَوْتِ أَوْ يَجْعَلَ اللَّهُ لَهُنَّ  
سَبِيلًا ﴿١٧﴾

وَالَّذِينَ يَأْتِيهِمَا مِنْكُمْ فَادُّوهُمَا ۚ فَإِنْ تَابَا  
وَأَصْلَحَا فَأَعْرِضُوا عَنْهُمَا ۚ إِنَّ اللَّهَ كَانَ  
تَوَّابًا رَحِيمًا ﴿١٨﴾

إِنَّمَا التَّوْبَةُ عَلَى اللَّهِ لِلَّذِينَ يَعْمَلُونَ  
السُّوْءَ يَجْهَالَةَ ثُمَّ يَتُوبُونَ مِنْ قَرِيبٍ  
فَأُولَئِكَ يَتُوبُ اللَّهُ عَلَيْهِمْ ۗ وَكَانَ اللَّهُ  
عَلِيمًا حَكِيمًا ﴿١٩﴾

وَلَيْسَتِ التَّوْبَةُ لِلَّذِينَ يَعْمَلُونَ السَّيِّئَاتِ ۚ  
حَتَّى إِذَا حَضَرَ أَحَدَهُمُ الْمَوْتُ قَالَ إِنِّي  
تُوبْتُ الْإِنِّ وَلَا الَّذِينَ يَمُوتُونَ وَهُمْ  
كُفَّارٌ ۗ أُولَئِكَ أَعْتَدْنَا لَهُمْ عَذَابًا  
أَلِيمًا ﴿٢٠﴾

20. O ju që besuat! Nuk ju lejohet që t'u merrni grave trashëgiminë me zor. Dhe mos i shqetësoni ato me qëllim që t'u merrni diçka nga ajo që ua keni dhënë, përveçse nëse ato bëjnë imoralitet hapur! Bashkëjetoni me to me mirësjellje! Nëse nuk i pëlqeni, atëherë mundet që ju të mos pëlqeni diçka, kurse Allahu të ketë lënë shumë të mira në të.<sup>4</sup>

21. Nëse dëshironi ta ndërroni bashkëshorten për një bashkëshorte tjetër, ndërkohë njëres prej tyre i keni dhënë një thesar pasurie, mos i merrni asgjë nga ai! A do t'ia merrni duke sajuar shpifje dhe duke bërë mëkat të hapur?!

22. E si mund ta merrni atë, derisa ju keni takuar njëri-tjetrin (me intimitet) dhe ato ju kanë marrë besë të fortë?!

23. Mos u martoni me gratë, me të cilat janë martuar baballarët tuaj, përveç asaj që ka ngjarë në të kaluarën. Kjo pa dyshim është e turpshme, e urryer dhe rrugë shumë e gabuar.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا يَحِلُّ لَكُمْ أَنْ تَرْتُوا النِّسَاءَ كَرْهًا وَلَا تَعْضُلُوهُنَّ لِتَذْهَبُوا بِبَعْضِ مَا آتَيْنَهُنَّ إِلَّا أَنْ يَأْتِيَنَّ بِفَاحِشَةٍ مُّبِينَةٍ وَعَاشِرُوهُنَّ بِالْمَعْرُوفِ فَإِنْ كَرِهْتُمُوهُنَّ فَعَسَى أَنْ تَكْرَهُوا شَيْئًا وَيَجْعَلَ اللَّهُ فِيهِ خَيْرًا كَثِيرًا ۝

وَأَنْ أَرَدْتُمْ اسْتِبْدَالَ زَوْجٍ مَكَانَ زَوْجٍ ۖ وَأَيْتِمُّوا أَحْدِهِنَّ قِطَارًا فَلَا تَأْخُذُوا مِنْهُ شَيْئًا ۖ تَأْخُذُونَهُ بُهْتَانًا وَإِنَّمَا مُّبِينًا ۝

وَكَيْفَ تَأْخُذُونَهُ وَقَدْ أَفْضَى بَعْضُكُمْ إِلَى بَعْضٍ وَأَخَذْنَ مِنْكُمْ مِيثَاقًا غَلِيظًا ۝

وَلَا تَنْكِحُوا مَا نَكَحَ آبَاؤُكُمْ مِنَ النِّسَاءِ إِلَّا مَا قَدْ سَلَفَ ۗ إِنَّهُ كَانَ فَاحِشَةً وَمَقْتًا ۚ

وَسَاءَ سَبِيلًا ۚ

4. Kurani i porosit burrat - Bashkëjetoni me gratë tuaja me mirësjellje. Edhe hadithi i Profetit<sup>saws</sup> e thekson - *Më i miri prej jush është ai që është më i miri ndaj gruas së tij* (Buhari, nr. 1977). Ky ajet nxit burrat të anashkalojnë shumë gjëra të cilat ata i shohin si të meta, duke thënë – *"mundet që ju të mos pëlqeni diçka, kurse Allahu të ketë lënë shumë të mira në të"*. Andaj, Islami i porosit burrat të sillen me butësi e me mirësi me gratë e tyre edhe në aspektin shoqëror, ashtu edhe në atë shpirtëror.

24. Ju janë ndaluar nënat tuaja, bijat tuaja, motrat tuaja, hallat tuaja, tezet tuaja, bijat e vëllait, bijat e motrës, nënat tuaja që ju kanë dhënë gjë, motrat tuaja të gjirit, nënat e bashkëshorteve tuaja, bijat e grave tuaja që u rritën në shtëpinë tuaj, nëse me ato gra keni bërë marrëdhënie bashkëshortore; nëse nuk keni bërë marrëdhënie, atëherë nuk është gjynah për ju. Po ashtu, gratë e bijve tuaj nga fara juaj dhe, gjithashtu, (ju ndalohej) të merrni dy motra për gra, përveç asaj që ka ngjarë në të kaluarën. Sigurisht, Allahu është shumë Mëkatfalës, shumë Mëshirëbërës.

حُرِّمَتْ عَلَيْكُمْ أُمَّهَاتُكُمْ وَبَنَاتُكُمْ  
وَآخَوَاتُكُمْ وَعَمَّاتُكُمْ وَخَالَاتُكُمْ وَبَنَاتُ  
الْأَخِ وَبَنَاتُ الْأَخِ وَأُمَّهَاتُ النِّسَاءِ  
الَّتِي أَزَّعْتُمْ وَأَخَوَاتُكُمْ مِنَ الرِّضَاعِ  
وَأُمَّهَاتُ نِسَائِكُمْ وَرَبَائِبُكُمُ الَّتِي فِي  
حُجُورِكُمْ مِنْ نِسَائِكُمُ الَّتِي دَخَلْتُمْ  
بِهِنَّ إِنْ لَمْ تَكُونُوا دَخَلْتُمْ بِهِنَّ فَلَا  
جُنَاحَ عَلَيْكُمْ وَحَلَائِلُ أَبَائِكُمُ الَّذِينَ  
مِنْ أَصْلَابِكُمْ وَأَنْ تَجْمَعُوا بَيْنَ  
الْأَخْتَيْنِ إِلَّا مَا قَدْ سَلَفَ إِنَّ اللَّهَ كَانَ  
عَفُورًا رَحِيمًا ﴿٥﴾

Xhuzi 5

25. Dhe (ju janë ndaluar edhe) gratë që kanë bashkëshortë, përveç atyre që janë në pronësinë tuaj. Kjo për ju është një detyrim nga Allahu. Dhe ju lejohen ato që janë jashtë kësaj, që ju t'i kërkoni me anë të pasurisë suaj, si të ndershëm e jo të shthurur. Jepuni si detyrim dhuratën e tyre martesore, për shkak të dobisë që keni pasur nga ato. Pasi të keni caktuar dhuratën martesore, nuk është gjynah për ju nëse gjeni mirëkuptim (për ndonjë ndryshim). Sigurisht, Allahu është i Gjithëdijshëm, i Urtë.<sup>5</sup>

وَالْمُحْصَنَاتُ مِنَ النِّسَاءِ إِلَّا مَا مَلَكَتْ  
أَيْمَانُكُمْ كَتَبَ اللَّهُ عَلَيْكُمْ وَأُجَلَ  
لَكُمْ مَا وَرَاءَ ذِكْرِهِ أَنْ تَبْتَغُوا  
بِأَمْوَالِكُمْ مُحْصِنِينَ غَيْرَ مُسْفِحِينَ  
فَمَا اسْتَعْتَمْتُمْ بِهِ مِنْهُنَّ فَآتُوهُنَّ  
أُجُورَهُنَّ فَرِيضَةً وَلَا جُنَاحَ عَلَيْكُمْ  
فِيمَا تَرَاضَيْتُمْ بِهِ مِنْ بَعْدِ الْفَرِيضَةِ إِنْ  
اللَّهُ كَانَ عَلِيمًا حَكِيمًا ﴿٥﴾

5. Fjala *ihsan* që vjen në këtë ajet, rrjedh nga *hisn*, e cila do të thotë *kështjellë*. Kurorëzimi (*nikahu*) u quajt *ihsan* për arsye se përmes tij njeriu hyn në "kështjellën" e sigurt të dëlirësisë dhe shpëton nga imoraliteti dhe nga shikimi i ndaluar. Më pas, duke pasur pasardhës, fiton jetëgjatësi. Po kështu, edhe trupi i tij ruhet nga një sërë disbalancash e sëmundjesh. Andaj, *nikahu* në çdo aspekt luan rolin e një kështjelle për njeriun.

26. Prej jush, ata që nuk kanë mundësi materiale të martohen me besimtaret e lira, (mund të martohen) me skllavet tuaja besimtare, që janë në pronësinë tuaj. Allahu e di më së miri besimin tuaj. Keni lidhje me njëri-tjetrin. Pra, martohuni me to me lejen e pronarëve të tyre dhe jepuni dhuratën e tyre martesore sipas rregullit, pra, ato të mbeten të ndershme e jo të shthurura dhe, as si ato që zënë dashnorë. E kur ato të martohen dhe pastaj të bëjnë ndonjë imoralitet, kanë gjysmën e ndëshkimit që u jepet grave të lira. Ky (lëshim) është për atë prej jush që i frikësohet mëkatit. Nëse duroni, do të jetë mirë për ju. Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

27. Allahu dëshiron që t'ju shpjegojë qartas, t'ju udhëzojë drejt praktikave të atyre që kanë qenë para jush dhe t'ju pranojë pendesën, duke ju mëshiruar. Allahu është i Gjithëdijshëm, i Urtë.

28. Allahu dëshiron t'ju pranojë pendesën, duke ju mëshiruar. Kurse ata që ndjekin tundimet, dëshirojnë që ju të anoni fort (nga ata).

29. Allahu dëshiron t'ju lehtësojë barrën dhe njeriu është krijuar i dobët.<sup>6</sup>

وَمَنْ لَّمْ يَسْتَطِعْ مِنْكُمْ طَوْلًا أَنْ يَنْكِحَ  
الْمُحْصَنَاتِ الْمُؤْمِنَاتِ فَمِنْ مَا مَلَكَتْ  
أَيْمَانُكُمْ مِنْ فَتَايِكُمُ الْمُؤْمِنَاتِ وَاللَّهُ  
أَعْلَمُ بِإِيمَانِكُمْ بَعْضُكُمْ مِنْ بَعْضٍ  
فَأَنْكِحُوهُنَّ بِإِذْنِ أَهْلِهِنَّ وَأَتُوهُنَّ  
أَجُورَهُنَّ بِالْمَعْرُوفِ مُحْصَنَاتٍ غَيْرَ  
مُسْفِهَاتٍ وَلَا تُنْكِحُوا الْمُحْصَنَاتِ  
أَحْصَنَ فَإِنْ أَتَيْنَ بِفَاحِشَةٍ فَعَلَيْهِنَّ  
نِصْفُ مَا عَلَى الْمُحْصَنَاتِ مِنَ الْعَذَابِ  
ذَلِكَ لِمَنْ خَشِيَ الْعَنَتَ مِنْكُمْ وَأَنْ  
تَصْبِرُوا خَيْرٌ لَكُمْ وَاللَّهُ غَفُورٌ رَحِيمٌ

يُرِيدُ اللَّهُ لِيُذَيِّبَ لَكُمْ وَيَهْدِيَكُمْ سُنَنَ  
الَّذِينَ مِنْ قَبْلِكُمْ وَيَتُوبَ عَلَيْكُمْ وَاللَّهُ  
عَلِيمٌ حَكِيمٌ

وَاللَّهُ يُرِيدُ أَنْ يَتُوبَ عَلَيْكُمْ وَيُرِيدُ  
الَّذِينَ يَتَّبِعُونَ الشَّهَوَاتِ أَنْ تَمِيلُوا مَيْلًا  
عَظِيمًا

يُرِيدُ اللَّهُ أَنْ يُخَفِّفَ عَنْكُمْ وَخُلِقَ  
الْإِنْسَانُ ضَعِيفًا

6. Njeriu është i dobët, për sa kohë që nuk merr fuqinë dhe ndihmën prej Zotit përmes lutjes. Pra, pa ndihmën e Tij, njeriu nuk e bën dot rrugëtimin e vështirë të përsosmërisë shpirtërore. Andaj, gjithmonë duhet të lutesh që Zoti të të mundësojë mirësinë, të ndihmojë e të bekojë ty.

30. O ju që besuat! Mos hani pasuritë tuaja në mes vete padrejtësisht. Po, vetëm nëse bëni ndonjë tregti me mirëkuptim të ndërsjellë. Mos vrisni veten (ekonomikisht)! Pa dyshim, Allahu është shumë Mëshirëbërës ndaj jush.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَأْكُلُوا أَمْوَالَكُمْ  
بَيْنَكُمْ بِالْبَاطِلِ إِلَّا أَنْ تَكُونَ تِجَارَةً  
عَنْ تَرَاضٍ مِّنْكُمْ وَلَا تَقْتُلُوا أَنْفُسَكُمْ ٥٠  
إِنَّ اللَّهَ كَانَ بِكُمْ رَحِيمًا ٥١

31. Ai që bën një gjë të tillë me dhunë e me mizori, së shpejti do të hidhet në zjarr. Dhe kjo është e lehtë për Allahun.

وَمَنْ يَفْعَلْ ذَلِكَ عُدْوَانًا وَظُلْمًا فَسَوْفَ  
نُصَلِّيهُ نَارًا ٥٢ وَكَانَ ذَلِكَ عَلَى اللَّهِ يَسِيرًا ٥٣

32. Nëse do t'u shmangeni mëkateve të mëdha që Ne ju kemi ndaluar, do t'jua zhdukim ligësitë tuaja dhe do t'ju çojmë në një vend të nderuar.

إِنْ تَجَنَّبُوا كِبَايِرَ مَا تُهَوَّنُ عَنْهُ نُكَفِّرْ  
عَنْكُمْ سَيِّئَاتِكُمْ وَنُدْخِلْكُمْ مُدْخَلًا  
كَرِيمًا ٥٤

33. Mos e lakmoni atë me të cilën Allahu u ka dhënë epërsi disave prej jush mbi disa të tjerë. Burrat kanë pjesë nga ajo që ata punojnë dhe gratë kanë pjesë nga ajo që ato punojnë. Kërkojini Allahut bekimin e Tij. Sigurisht, Allahu është i Gjithëdijshtëm për çdo gjë.

وَلَا تَتَمَنَّوْا مَا فَضَّلَ اللَّهُ بِهِ بَعْضَكُمْ عَلَى  
بَعْضٍ ٥٥ لِلرِّجَالِ نَصِيبٌ مِّمَّا اكْتَسَبُوا ٥٦  
وَاللِّسَاءِ نَصِيبٌ مِّمَّا اكْتَسَبْنَ ٥٧ وَسَأَلُوا  
اللَّهَ مِنْ فَضْلِهِ ٥٨ إِنَّ اللَّهَ كَانَ بِكُلِّ شَيْءٍ  
عَلِيمًا ٥٩

34. Për (dobinë) e çdokujt kemi caktuar trashëgimtarë të asaj (pasurie) që lënë prindërit dhe të afërmit. Dhe atyre që u keni bërë premtime të forta, jepuani pjesën e tyre. Pa dyshim, Allahu është Mbikëqyrës i çdo gjëje.

وَلِكُلِّ جَعَلْنَا مَوَالِي مِمَّا تَرَكَ الْوَالِدِينَ  
وَالْأَقْرَبُونَ ٦٠ وَالَّذِينَ عَقَدَتْ أَيْمَانُكُمْ  
فَأْتَوْهُمْ نَصَيْبَهُمْ ٦١ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلَى كُلِّ  
شَيْءٍ شَهِيدًا ٦٢

35. Burrat janë kujdestarë të grave për shkak të epërsisë që Zoti u ka dhënë disave prej jush mbi disa të tjerë, gjithashtu, edhe për shkak se ata shpenzojnë nga pasuritë e tyre

الرِّجَالُ قَوْمُونَ عَلَى النِّسَاءِ بِمَا فَضَّلَ اللَّهُ  
بَعْضَهُمْ عَلَى بَعْضٍ ٦٣ وَبِمَا أَنْفَقُوا مِنْ  
أَمْوَالِهِمْ ٦٤ فَالضَّلِيلَةُ فَمَنْتِ حِفْظِي

(për to). Andaj, gratë e sinqerta janë të bindurat dhe ruajtëset, edhe në fshehtësi, të asaj për të cilën Allahu i ka porositur ta ruajnë. Dhe nga ato që keni frikë për rebelimin e tyre, (së pari) këshillojini pastaj lërinin të veçuara në shtrat, pastaj (nëse lyp nevoja) ndëshkojini fizikisht. Nëse ju binden, mos kërkon argument kundër tyre. Sigurisht, Allahu është shumë i Lartë, shumë i Madh.<sup>7</sup>

36. Nëse druheni për kundërshtim të ashpër midis të dyve (burrit dhe gruas), caktoni një të mençur nga familja e tij dhe një të mençur nga

لِّلَّغَيْبِ بِمَا حَفِظَ اللَّهُ ۗ وَالَّتِي تَخَافُونَ  
تُسَوِّرَهُنَّ فَعِظُوهُنَّ وَاهْجُرُوهُنَّ فِي  
الْمَضَاجِعِ وَأَضْرِبُوهُنَّ ۚ فَإِنْ أَطَعْنَكُمْ  
فَلَا تَبْعُوا عَلَيْهِنَّ سَبِيلًا ۗ إِنَّ اللَّهَ كَانَ  
عَلِيمًا كَبِيرًا ﴿٣٦﴾

وَأِنْ خِفْتُمْ شِقَاقَ بَيْنِهِمَا فَابْعَثُوا حَكَمًا  
مِّنْ أَهْلِهِ وَحَكَمًا مِّنْ أَهْلِهَا ۗ إِنْ يُرِيدَا  
إِصْلَاحًا يُوَفِّقِ اللَّهُ بَيْنَهُمَا ۗ إِنَّ اللَّهَ كَانَ

7. *"Burrrat janë kujdestarë të grave"*: një kuptim i drejtpërdrejtë është që burrat fizikisht janë më të fuqishëm sesa gratë, në përgjithësi. Në këtë aspekt, nëse burrat nuk bëhen kujdestarë, mundet që gratë të dëmtohen. Së dyti, ata burra janë kujdestarë, të cilët me shpenzimet e tyre i mbajnë gratë e tyre. Kurse ata që jetojnë me të ardhurat e grave, nuk mund të gëzojnë të drejtën të quhen kujdestarë. Zoti nga njëra anë e quajti burrin kujdestar duke i dhënë edhe forcën fizike, dhe nga ana tjetër, e obligoi me shpenzimet ndaj gruas dhe fëmijëve, kurse gruan e porositi që nëse burri përmbush obligimet e tij, ajo ka për detyrë të mbarështojë shtëpinë dhe të ruajë qetësinë shpirtërore, dhe po kështu, në mungesën e burrit, të mos lejojë të dëmtohet nderi i familjes. Kështu që, Zoti i Madhërishëm porosit edhe burrin, edhe gruan të plotësojnë detyrimet që kanë ndaj njëri-tjetrit. Në pjesën e fundit të ajetit sqarohet se nëse jeni kujdestarë të denjë dhe prapëseprapë, gratë tuaja kanë natyrë rebele, nuk ju lejohet t'i ndëshkoni menjëherë, por së pari, duhet t'i këshilloni. Nëse nuk jua pranojnë këshillën, të tërhiqeni nga marrëdhëniet bashkëshortore për një kohë. Nëse prapë nuk zbuten dhe vijojejnë të sillen në rebelim, atëherë keni leje t'i ndëshkoni fizikisht, por, në lidhje me këtë, Profeti Muhammed<sup>savs</sup> tha: *Nuk duhet t'i qëlloni në fytyrë dhe nuk duhet t'i ndëshkoni në një mënyrë që atyre t'u mbetet shenjë në trup* (Muslim, nr. 1217). Duke iu referuar këtij ajeti, shumë burra tentojnë të justifikojnë keqtrajtimet dhe mizoritë e tyre ndaj grave të tyre, kurse në të vërtetë, nëse i plotësojnë kushtet e përmendura në këtë ajet, nuk do të lindë fare nevoja për ndonjë ndëshkim fizik. Po të ishte i lejuar ndëshkimi fizik, do të gjenim qoftë një shembull në jetën e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, që ai të ketë ndëshkuar fizikisht ndonjërin prej bashkëshorteve të tij, edhe pse ka pasur raste, kur disa nga gratë e tij kanë shkaktuar mospëlqimin e tij. Madje, Profeti<sup>savs</sup> shpesh këshillonte: *"ushqeje gruan tënde siç ushqehesh, vishë siç vishesh, mos ia shaj fytyrën dhe mos e rrih"* (Ebu Davud, nr. 2143). Pak ajete më parë, Kurani i porosit burrat t'i tolerojnë gratë, të bashkëjetojnë me mirësjellje, të anashkalojnë dobësitë e tyre, përveçse nëse bëjnë imoralitet të hapur (4:20). Përveç kësaj, Kurani i siguron gruas të drejtën e ndarjes nga burri, në çdo rast ku ajo sheh të pamundur të vijoje bashkëjetesën me të (2:230).



familja e saj. Nëse ata (burri e gruaja) dëshirojnë të përmirësohen, Allahu do t'u mundësojë mirëkuptimin të dyve. Sigurisht, Allahu është i Gjithëdijshëm, i Gjithinformuar.

عَلِيمًا حَبِيرًا ﴿٣٦﴾

37. Adhurojeni Allahun dhe mos shoqëroni asgjë me Të në adhurim. Bëjuni mirësi prindërve, të afërmeve, jetimëve, të varfërve, fqinjëve farefis dhe fqinjëve jofarefis, shokëve, udhëtarëve dhe atyre që janë në pronësinë tuaj. Pa dyshim, Allahu nuk e do atë që është mendjemadh, mburracak.

وَاعْبُدُوا اللَّهَ وَ لَا تُشْرِكُوا بِهِ شَيْئًا  
وَّ بِالْوَالِدَيْنِ إِحْسَانًا وَ بِذِي الْقُرْبَىٰ  
وَآلِئْسَىٰ وَالْمَسْكِينِ وَ الْجَارِ ذِي الْقُرْبَىٰ  
وَ الْجَارِ الْجُنُبِ وَ الصَّاحِبِ بِالْجَنبِ  
وَ ابْنِ السَّبِيلِ ۗ وَ مَا مَلَكَتْ أَيْمَانُكُمْ ۗ إِنَّ  
اللَّهَ لَا يُحِبُّ مَنْ كَانَ مُخْتَالًا فَخُورًا ﴿٣٧﴾

38. (Domethënë) ata që janë koprracë dhe urdhërojnë njerëzit të bëhen koprracë dhe fshehin atë që Allahu ua ka dhënë nga bekimi i Tij. Ne kemi përgatitur ndëshkim poshtërues për mohuesit;

الَّذِينَ يَبْخُلُونَ وَيَأْمُرُونَ النَّاسَ بِالْبُخْلِ  
وَ يُكْتُمُونَ مَا آتَاهُمُ اللَّهُ مِنْ فَضْلِهِ ۗ  
وَ اعْتَدْنَا لِلْكَافِرِينَ عَذَابًا مُهِينًا ﴿٣٨﴾

39. dhe ata që shpenzojnë pasuritë e tyre sa për sy e faqe të njerëzve dhe nuk besojnë as në Allah dhe as në Ditën e *Ahiretit*. Ai që ka shok djallin (le ta dijë se) sa shok i keq është ai.

وَ الَّذِينَ يُنْفِقُونَ أَمْوَالَهُمْ رِئَاءَ النَّاسِ  
وَ لَا يُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَ لَا بِالْيَوْمِ الْآخِرِ ۗ وَ مَنْ  
يَكُنِ الشَّيْطَانُ لَهُ قَرِينًا فَسَاءَ قَرِينًا ﴿٣٩﴾

40. E çfarë pengese kanë ata që të besojnë në Allah dhe (në) Ditën e *Ahiretit* dhe të shpenzojnë nga ajo që u ka dhënë Allahu! Allahu është i Gjithëdijshëm për ta.

وَ مَا ذَا عَلَيْهِمْ لَوْ آمَنُوا بِاللَّهِ وَ الْيَوْمِ الْآخِرِ  
وَ أَنْفَقُوا مِمَّا رَزَقَهُمُ اللَّهُ ۗ وَ كَانَ اللَّهُ بِهِمْ  
عَلِيمًا ﴿٤٠﴾

41. Pa dyshim, Allahu nuk bën padrejtësi asnjë grimë. Dhe kur ka ndonjë të mirë, Ai e shumëfishon atë, dhe, edhe nga ana e Tij, jep shpërblim të madh.

إِنَّ اللَّهَ لَا يَظْلِمُ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ ۗ وَإِنْ تَكَ  
حَسَنَةً يُضْعِفْهَا وَيُؤْتِ مِنْ لَدُنْهُ أَجْرًا  
عَظِيمًا ﴿٤١﴾

42. E si do të jetë kur do të sjellim një dëshmitar nga çdo popull, dhe ty do të të sjellim si dëshmitar mbi të gjithë ata?!

43. Ditën kur ata që e mohuan dhe e kundërshtuan të Dërguarin, do të duan të rrafshohen me tokën. Ata nuk do të fshehin dot asnjë fjalë nga Allahu.

44. O ju që besuat! Mos iu afroni namazit kur jeni të pavetëdijshëm, derisa (të ktheheni në gjendje) ta kuptoni atë që thoni; as kur jeni të papastër (pra, *xhunubë*),<sup>8</sup> derisa të laheni, përveçse kur jeni udhëtarë. Dhe kur jeni të sëmurë ose udhëtarë ose keni kryer nevojën ose keni bërë marrëdhënie me gratë dhe nuk gjeni ujë, bëni *tejumum* me dhe të thatë e të pastër, pra, fërkoni fytyrat dhe duart tuaja. Sigurisht, Allahu është shumë Tolerant, shumë Falës.

45. A nuk ke menduar për ata, të cilëve u ishte dhënë një pjesë e Librit, por ata “blejnë” humbjen dhe dëshirojnë që (edhe) ju të humbni rrugën?!

46. Allahu i di më së miri armiqtë tuaj. Allahu mjafton si Mik dhe Allahu mjafton si Ndihmës.

47. Mes hebrenjve ka të atillë që i ndërrojnë fjalët nga vendi i

فَكَيْفَ إِذَا جِئْنَا مِنْ كُلِّ أُمَّةٍ بِشَهِيدٍ  
وَجِئْنَا بِكَ عَلَى هَؤُلَاءِ شَهِيدًا ۝٤٢

يَوْمَئِذٍ يَوْمَئِذٍ الَّذِينَ كَفَرُوا وَعَصُوا  
الرَّسُولَ لَوْ تُسَوَّى بِهِمُ الْأَرْضُ وَلَا  
يَكْتُمُونَ اللَّهَ حَدِيثًا ۝٤٣

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَقْرَبُوا الصَّلَاةَ  
وَأَنْتُمْ سُكَرَىٰ حَتَّىٰ تَعْلَمُوا مَا تَقُولُونَ  
وَلَا جُبْنًا إِلَّا عَابِرِي سَبِيلٍ حَتَّىٰ  
تَغْتَسِلُوا ۖ وَإِنْ كُنْتُمْ مَرْضَىٰ أَوْ عَلَىٰ سَفَرٍ  
أَوْ جَاءَ أَحَدٌ مِنْكُم مِّنَ الْغَائِطِ أَوْ  
لَمَسْتُمُ النِّسَاءَ فَلَمْ تَجِدُوا مَاءً فَتَيَمَّمُوا  
صَعِيدًا طَيِّبًا فَامْسَحُوا بِرُءُوسِكُمْ  
وَإَيْدِيكُمْ ۖ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَفُورًا ۝٤٤

أَلَمْ تَرَ إِلَى الَّذِينَ أُوتُوا نَصِيبًا مِّنَ الْكِتَابِ  
يَشْتَرُونَ الضَّلَاةَ وَيُرِيدُونَ أَنْ تَضَلُّوا  
السَّبِيلَ ۝٤٥

وَاللَّهُ أَعْلَمُ بِأَعْدَائِكُمْ ۖ وَكَفَىٰ بِاللَّهِ  
وَلِيًّا ۖ وَكَفَىٰ بِاللَّهِ نَصِيرًا ۝٤٦

مِنَ الَّذِينَ هَادُوا يُحَرِّفُونَ الْكَلِمَ عَن

8. Këtu fjala arabe për papastërtinë është “xhunub”, e cila bën fjalë për papastërtinë që shkaktohet nga marrëdhëniet bashkëshortore ose nga derdhja e farës. (Lexoni edhe 5:7)

tyre dhe thonë: “Ne dëgjuam dhe kundërshtuam, dëgjo sikur nuk ke dëgjuar, ‘*raina*’”,<sup>9</sup> duke shtrembëruar gjuhën e tyre dhe duke bërë ironi me besimin. Nëse do të thoshin: “dëgjuam dhe u bindëm”; “dëgjo” dhe “na shiko”, do të ishte më e mirë dhe më e qëndrueshme (si fjalë) për ta. Por Allahu i ka mallkuar ata për shkak të mohimit të tyre. Andaj, ata nuk besojnë, përveç një gjëje të vogël.

48. O ju që ju është dhënë Libri! Besojeni atë që kemi zbritur si vërtetues i asaj që keni me vete, përpara se Ne të damkosim disa fytyra e t'i kthejmë mbrapsht ato ose t'i mallkojmë, siç i mallkuam njerëzit e *sabatit*. Vendimi i Allahut është punë e kryer.<sup>10</sup>

49. Allahu nuk fal që t'i atribuosh ortak Atij dhe përveç kësaj fal çdo gjë tjetër, për atë që do Ai. Ai që i atribuon ortak Allahut, përnjëmend ka shpikur mëkat të madh.

50. A i ke vënë re ata që vlerësojnë veten të pastër?! Por, e vërteta është që Allahu e bën të pastër kë të dojë. Atyre asnjë fije nuk do t'u bëhet padrejtësi.

51. Shiko se si ata shpifin gënjeshtria mbi Allahun. Dhe kjo është e mjaftueshme për të qenë mëkat i hapur.

مَوَاضِعِهِ وَيَقُولُونَ سَمِعْنَا وَعَصَيْنَا  
وَأَسْمَعُ غَيْرَ مَسْمُوعٍ وَرَاعِنَا لَيًّا بِأَلْسِنَتِهِمْ  
وَطَعْنًا فِي الدِّينِ ۗ وَلَوْ أَنَّهُمْ قَالُوا سَمِعْنَا  
وَاطَعْنَا وَأَسْمَعُ ۖ وَأَنْظُرْنَا لَكَانَ خَيْرًا لَّهُمْ  
وَأَقْوَمًا ۗ وَلَكِنْ لَعَنَهُمُ اللَّهُ بِكُفْرِهِمْ فَلَا  
يُؤْمِنُونَ إِلَّا قَلِيلًا ﴿٤٧﴾

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ ائْمُونًا بِمَا نَزَّلْنَا  
مُصَدِّقًا لِمَا مَعَكُمْ مِّن قَبْلِ أَنْ تُطْمَسَ  
وُجُوهًا فَتَرُدَّهَا عَلَىٰ أَدْبَارِهَا أَوْ نَلْعَنَهُمْ  
كَمَا لَعَنَّا أَصْحَابَ السَّبْتِ ۗ وَكَانَ أَمْرُ  
اللَّهِ مَفْعُولًا ﴿٤٨﴾

إِنَّ اللَّهَ لَا يَغْفِرُ أَنْ يُشْرَكَ بِهِ وَيَغْفِرُ  
مَا دُونَ ذَلِكَ لِمَنْ يَشَاءُ ۗ وَمَنْ يُشْرِكْ  
بِاللَّهِ فَقَدِ افْتَرَىٰ إِثْمًا عَظِيمًا ﴿٤٩﴾

أَلَمْ تَرَ إِلَى الَّذِينَ يَرْكَبُونَ أَنفُسَهُمْ ۗ بَلِ  
اللَّهُ يُرِيكُم مِّنْ شَيْءٍ وَلَا يُظَلِّمُونَ فِتْنِيلًا ﴿٥٠﴾

أَنْظُرْ كَيْفَ يُفْتَرُونَ عَلَى اللَّهِ الْكَذِبَ ۗ  
وَكَفَىٰ بِهِ إِثْمًا مُّبِينًا ﴿٥١﴾

9. Lexoni 2:105.

10. Mallkimi që përmendet në këtë ajet, shpjegohet më gjerësisht në 7:164-167.

52. A nuk i ke parë ata të cilëve u ishte dhënë një pjesë e Librit, (që) besojnë në idhuj e në djall dhe për mohuesit thonë: “Këta janë më të saktë për nga rruga, sesa ata që besuan”?!

53. Pikërisht këta i ka mallkuar Allahu. Për atë që e mallkon Allahu, nuk mund të gjesh asnjë ndihmës.

54. A kanë ata pjesë në sundim?! Atëherë, ata nuk do t’u jepnin njerëzve asnjë grimë.

55. A u kanë zili njerëzve për shkak të asaj që Allahu u ka dhënë nga bekimi i Tij? Atëherë, Ne i dhamë edhe popullit të Ibrahimit Librin dhe urtësinë dhe i dhamë edhe pushtet madhështor.

56. Prej tyre ka edhe të tillë që e besoi atë dhe prej tyre ka edhe të tillë që iu shmang, dhe, (për këtë të fundit), xhehenemi flakërues është i mjaftueshëm.

57. Ata që mohuan shenjat Tona, Ne do t’i fusim në zjarr. Sa herë që do t’u piqet lëkura, do t’ua ndërrojmë me një lëkurë tjetër, që ata ta “shijojnë” ndëshkimin. Pa dyshim, Allahu është Mbizotërues, i Urtë.

58. Ata që besuan dhe bënë të mira, Ne do t’i shpiem në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Ata në to do të jetojnë përgjithmonë. Do të kenë bashkëshortë të dëlirë. Dhe Ne do t’i shpiem ata në hije të gjera.

أَلَمْ تَرَ إِلَى الَّذِينَ أُوتُوا نَصِيًّا مِنَ الْكِتَابِ  
يُؤْمِنُونَ بِالْحَبِيبِ وَالطَّاغُوتِ وَيَقُولُونَ  
لِلَّذِينَ كَفَرُوا هُوَ أَهْدَىٰ مِنَ الَّذِينَ  
آمَنُوا سَبِيلًا ﴿٥٢﴾

أُولَٰئِكَ الَّذِينَ لَعَنَهُمُ اللَّهُ وَمَنْ يَلْعَنِ  
اللَّهُ فَلَنْ تَجِدَ لَهُ نَصِيرًا ﴿٥٣﴾

أَمْ لَهُمْ نَصِيبٌ مِنَ الْمَلَكِ فَإِذَا لَا يُؤْتُونَ  
النَّاسَ نَقِيرًا ﴿٥٤﴾

أَمْ يَحْسُدُونَ النَّاسَ عَلَىٰ مَا آتَاهُمُ اللَّهُ  
مِنْ فَضْلِهِ ۚ فَقَدْ آتَيْنَا آلَ إِبْرَاهِيمَ الْكِتَابَ  
وَالْحِكْمَةَ وَآتَيْنَاهُمْ مُلْكًا عَظِيمًا ﴿٥٥﴾

فَمِنْهُمْ مَنْ آمَنَ بِهِ وَمِنْهُمْ مَنْ صَدَّ عَنْهُ  
وَكَفَىٰ بِجَهَنَّمَ سَعِيرًا ﴿٥٦﴾

إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا بِآيَاتِنَا سَوْفَ نُصَلِّيهِمْ  
نَارًا ۚ كُلَّمَا نَضِجَتْ جُلُودُهُمْ بَدَّلْنَاهُمْ  
جُلُودًا غَيْرَهَا لِيَذُوقُوا الْعَذَابَ ۗ إِنَّ اللَّهَ  
كَانَ عَزِيزًا حَكِيمًا ﴿٥٧﴾

وَالَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ  
سَنُدْخِلُهُمْ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا  
الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا أَبَدًا ۗ لَهُمْ فِيهَا  
أَزْوَاجٌ مُطَهَّرَةٌ وَهُمْ فِيهَا ضُلَّالًا  
ظَلِيلًا ﴿٥٨﴾

59. Sigurisht, Allahu ju urdhëron t'ua dorëzoni amanetet atyre që u takojnë,<sup>11</sup> dhe, kur të qeverisni njerëzit, të qeverisni me drejtësi. Është shumë e mirë ajo që ju këshillon Allahu. Pa dyshim, Allahu është Gjithëdhëgues, Gjithëshikues.

60. O ju që besuat! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit si dhe atyre që janë autoritete midis jush. Nëse bini ndesh (me autoritetet) në ndonjë çështje, kthejeni atë tek Allahu dhe i Dërguari, nëse besoni Allahun dhe Ditën e *Ahiretit*. Në fund, kjo do të jetë më e mirë dhe më e mbarë.<sup>12</sup>

61. A i ke parë ata, të cilët pretendojnë se kanë besuar atë që të është zbritur ty, si dhe atë që është zbritur para teje (dhe që) duan të gjykohen te djalli, ndërkohë ata janë urdhëruar ta mohojnë atë?! Djalli dëshiron që t'i shpjerë ata në humbje të thellë.

11. Në këtë ajet, fjala *amanetet* nënkupton të drejtën e zgjedhjes për të qeverisur. Kështu që, edhe vota është një amanet, të cilën duhet t'ia japësh atij që e meriton. Kjo quhet demokraci e drejtë. Dhe, pasi të kesh marrë qeverisjen me mirëbesim, duhet të punosh me drejtësi dhe jo për interesa partiake. Në demokraci të gënjeshtërtë të kohës aktuale, standardi i drejtësisë zbatohet vetëm për anëtarët e partisë në pushtet, ndërsa me të tjerët, jo.

12. Në këtë ajet, duke përkthyer fjalët "*ulul-emri minkum*", (autoritete midis jush) disa dijetarë pohojnë se Kurani porositi të zgjidhni përgjegjës vetëm nga muslimanët dhe se nuk ka nevojë t'u bindeni autoriteteve që nuk janë muslimanë. Së pari, ky është një mendim absurd që del në shesh me një analizë të thjeshtë të këtij ajeti. Të gjithë muslimanët që jetojnë në shtetet *jo-islamike* ose që mërgojnë atje, janë të obliguar të zbatojnë ligjet e atyre vendeve. Së dyti, nëse porositja në fjalë do t'u referohej vetëm autoriteteve muslimane, nuk do të lindte pyetja që muslimanët të mund të kenë kundërshtime me ta në ndonjë çështje, të cilën do t'u duhej ta kthenin tek Allahu dhe i Dërguari i Tij. Fjalët "tek Allahu dhe i Dërguari" qartësisht i referohen mësimet të Kuranit. Kështu, cilido përgjegjës, qoftë musliman apo jomusliman, nëse ju jep urdhër që është në kundërshtim me mësimet bazë të Kuranit, duhet t'i bindeni Kuranit dhe jo autoritetit. Kështu që, Kurani porositi qartazi për bindjen ndaj autoriteteve dhe fjalët "prej jush" përfshijnë edhe shtetin. Në çdo gjë që të thotë shteti dhe që nuk bie ndesh me parimet themelore të fesë, duhet t'i bindesh dhe duhet të bashkëpunosh me të.

إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُكُمْ أَنْ تُؤَدُّوا الْأَمَانَاتِ إِلَىٰ  
أَهْلِهَا ۖ وَإِذَا حَكَمْتُمْ بَيْنَ النَّاسِ أَنْ  
تَحْكُمُوا بِالْحَدْلِ ۗ إِنَّ اللَّهَ نِعِمَّا يَعِظُكُمْ بِهِ ۗ  
إِنَّ اللَّهَ كَانَ سَمِيعًا بَصِيرًا ﴿٥٩﴾

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا أَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا  
الرَّسُولَ وَأُولِي الْأَمْرِ مِنْكُمْ ۚ فَإِنْ  
تَنَازَعْتُمْ فِي شَيْءٍ فَرُدُّوهُ إِلَى اللَّهِ  
وَالرَّسُولِ إِنْ كُنْتُمْ تُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ  
الْآخِرِ ۗ ذَلِكَ خَيْرٌ وَأَحْسَنُ تَأْوِيلًا ﴿٦٠﴾

أَلَمْ تَرَ إِلَى الَّذِينَ يَزْعُمُونَ أَنَّهُمْ آمَنُوا  
بِمَا أُنزِلَ إِلَيْكَ وَمَا أُنزِلَ مِنْ قَبْلِكَ  
يُرِيدُونَ أَنْ يُتَحَاكَمُوا إِلَى الطَّاغُوتِ  
وَقَدْ أُمِرُوا أَنْ يَكْفُرُوا بِهِ ۗ وَيُرِيدُ  
الشَّيْطَانُ أَنْ يُضِلَّهُمْ ضَلَالًا بَعِيدًا ﴿٦١﴾

62. Kur u thuhet: “Ejani tek ajo që zbriti Allahu dhe tek i Dërguari!”, do t’i shohësh hipokritët që largohen shumë prej teje.

63. Pastaj, çfarë u ndodh që kur i godet ndonjë vështirësi për shkak të asaj që vetë duart e tyre kanë çuar përpara, ata vijnë te ti, duke u betuar në Allah: “Ne thjesht donim mirësi dhe pajtim”.

64. Këtyre njerëzve Allahu ua di zemrat. Prandaj, shmangiu atyre, këshilloji dhe thuaju një fjalë që u lë ndikim të thellë në shpirtin e tyre.

65. Nuk kemi sjellë ndonjë të dërguar, përveçse (njerëzit) t’i bindeshin atij me urdhrin e Allahut. Po të vinin ata te ti në kohën kur i kishin bërë keq vetvetes e t’i kërkonin falje Allahut dhe, edhe (ti që je) i Dërguar të kërkoje falje për ta, ata do ta gjenin Allahun shumë Pendimpranues, shumë Mëshirëbërës.

66. Jo! Për Zotin tënd! Ata nuk kanë besuar, derisa nuk të marrin ty si gjykatës në çështjet që kanë shkaktuar grindje midis tyre, më pas, të mos gjejnë asnjë ngushtim në shpirtin e tyre nga gjykimi yt e të tregohen plotësisht të bindur.

67. Po t’i detyronim ata të vrisnin veten e tyre apo të braktisnin shtëpitë e tyre, nuk do ta bënin, përveç një pakice prej tyre. Dhe sikur ta bënin atë që u është këshilluar, do të ishte

وَإِذَا قِيلَ لَهُمْ تَعَالَوْا إِلَىٰ مَا أَنْزَلَ اللَّهُ  
وَأِلَى الرَّسُولِ رَأَيْتَ الْمُنْفِقِينَ  
يَصُدُّونَ عَنْكَ صُدُودًا ۝

فَكَيْفَ إِذَا آصَابَتْهُمُ مُصِيبَةٌ بِمَا قَدَّمَتْ  
أَيْدِيَهُمْ ثُمَّ جَاءُوكَ يَحْلِفُونَ ۗ بِاللَّهِ إِنْ  
أَرَدْنَا إِلَّا إِحْسَانًا وَتَوْفِيقًا ۝

أُولَٰئِكَ الَّذِينَ يَعْلَمُ اللَّهُ مَا فِي قُلُوبِهِمْ ۗ  
فَأَعْرَضَ عَنْهُمْ وَعَظَّمَهُمْ وَقَالَ لَهُمْ فِي  
أَنْفُسِهِمْ قَوْلًا بَلِيغًا ۝

وَمَا أَرْسَلْنَا مِنْ رَّسُولٍ إِلَّا لِيُطَاعَ بِإِذْنِ  
اللَّهِ ۗ وَلَوْ أَنَّهُمْ إِذْ ظَلَمُوا أَنْفُسَهُمْ  
جَاءُوكَ فَاسْتَغْفَرُوا اللَّهَ وَاسْتَغْفَرَ لَهُمُ  
الرَّسُولُ لَوَجَدُوا اللَّهَ تَوَّابًا رَحِيمًا ۝

فَلَا وَرَبِّكَ لَا يُؤْمِنُونَ حَتَّىٰ يُحَكِّمُوكَ  
فِيمَا شَجَرَ بَيْنَهُمْ ثُمَّ لَا يَجِدُوا فِي  
أَنْفُسِهِمْ حَرَجًا مِّمَّا قَضَيْتَ وَيَسْلَمُوا  
تَسْلِيمًا ۝

وَلَوْ أَنَّا كَتَبْنَا عَلَيْهِمْ أَنْ اقْتُلُوا أَنْفُسَكُمْ  
أَوْ اخْرَجُوا مِنْ دِيَارِكُمْ مَا فَعَلُوهُ إِلَّا  
قَلِيلٌ مِّنْهُمْ ۗ وَلَوْ أَنَّهُمْ فَعَلُوا مَا

mirë për ta dhe kjo do t'i forconte fuqishëm ata.

68. Në këtë rast, Ne me siguri do t'u jepnim prej Vetes shpërblim të madh

69. dhe do t'i udhëzonim ata në rrugë të drejtë.

70. Dhe kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata që Allahu i ka bekuar, (pra, do të jetë) ndër Profetët, të vërtetët, dëshmorët dhe të dëlirët. Sa shoqëri e mbarë janë këta!<sup>13</sup>

71. Ky është bekimi nga Allahu. Allahu është i vetëmjaftueshëm për të qenë i Gjithëdijshëm.

72. O ju që besuat! Merrni masat për shpëtimin tuaj! Pastaj, dilni në çeta të vogla ose të gjithë së bashku.

73. Pa dyshim, mes jush ka edhe të atillë që do të vonohen. Kur ju godet

يُوْعَظُونَ بِهِ لَكَانَ خَيْرًا لَّهُمْ وَ أَسَدَّ  
تَثِيْنًا ﴿١٦﴾

وَ إِذَا لَمْ يَنْتَهِبْ مِنْ دُونِهَا جَرَاعِيًّا ﴿١٧﴾

وَأَهْدِيْهُمْ صِرَاطًا مُّسْتَقِيْمًا ﴿١٨﴾

وَمَنْ يُطِيعِ اللَّهَ وَالرَّسُوْلَ فَأُوْلَئِكَ مَعَ  
الَّذِيْنَ أَنْعَمَ اللَّهُ عَلَيْهِمْ مِنَ النَّبِيِّنَ  
وَالصّٰدِقِيْنَ وَالشّٰهَدَآءِ وَالصّٰلِحِيْنَ  
وَ حَسَنٌ أُوْلَئِكَ رَفِيْقًا ﴿١٩﴾

ذٰلِكَ الْفَضْلُ مِنَ اللَّهِ وَ كَفَىٰ بِاللَّهِ  
عَلِيْمًا ﴿٢٠﴾

يٰۤاَيُّهَا الَّذِيْنَ آمَنُوْا حٰذِرُوْا جُنُوْدَكُمْ  
فَإِنْفِرُوْا ثُبَاتٍ أَوْ اِنْفِرُوْا جَمِيْعًا ﴿٢١﴾

وَ إِن مِّنْكُمْ لَمَنْ يُؤْبِطُنَّ ۚ فَإِنْ أَصَابَتْكُمْ  
مُّصِيْبَةٌ قَالِ قَدْ أَنْعَمَ اللَّهُ عَلَيَّ إِذْ لَمْ

13. Ky ajet ka disa tregues që kërkojnë vëmendje. Së pari, fjala “i Dërguari” i referohet Profetit Muhammed<sup>savs</sup>. Së dyti, thuhet se nëse do t'i bindeni këtij të dërguari, do të bëheni ndër ata, në të cilët përfshihen profetët, të vërtetët, dëshmorët dhe të dëlirët. Kjo tregon se me ndjekjen e Profetit Muhammed<sup>savs</sup> dikush mund të bëhet edhe profet. Disa dijetarë këmbëngulin se parafjala “*ma'a*” (me) ka kuptimin që ndjekësit e Profetit Muhammed<sup>savs</sup> do të jenë bashkë me Profetët dhe vetë nuk do të jenë profetë. Një përkthim a komentim i tillë është fyerje ndaj tij, sepse në këtë rast do t'u duhet të thonë se ndjekësit e Profetit Muhammed<sup>savs</sup> do të jenë bashkë me Profetët, kurse vetë nuk do të jenë të tillë, do të jenë bashkë me të vërtetët, kurse vetë nuk do të jenë të tillë, do të jenë bashkë me dëshmorët, kurse vetë nuk do të jenë të tillë dhe do të jenë bashkë me të dëlirët dhe vetë nuk do të jenë të tillë. Parafjala “*ma'a*” (me), në shumë ajete të Kuranit të Shenjtë, ka kuptimin e parafjalës “ndër”. Për shembull: 3:194, 4:147, 5:84, 15:32 etj.. Përveç kësaj, pas fjalëve “me ata që Allahu i ka bekuar”, vijnë fjalët “*minen-nebijjin*” (me Profetët), në këtë rast parafjala “*min*” në gjuhën arabe është “*bejanijeh*”, çka jep kuptimin e parafjalës “ndër”. Lexoni edhe 33:41; 22:76.

ju ndonjë vështirësi, (një njeri i tillë) thotë: “Allahu më ka bekuar mua, që nuk u bëra pjesë e tyre për ta dëshmuar (këtë fatkeqësi)”.

أَكُنْ مَعَهُمْ شَهِيدًا ﴿٧٤﴾

74. Dhe kur ju vjen ndonjë bekim prej Allahut, ai, ashtu sikur nuk ka pasur dashuri midis vetes e jush, patjetër do të thotë: “Eh sikur të isha me ta, që të gëzoja një sukses madhështor!”

وَلَيْنِ أَصَابَكُمْ فَضْلٌ مِّنَ اللَّهِ لَيَقُولَنَّ  
كَانَ لَمْ تَكُنْ بَيْنَكُمْ وَبَيْنَهُ مَوَدَّةٌ يَلْبِئْتَنِي  
كُنْتُ مَعَهُمْ فَأَفُوزَ فَوْزًا عَظِيمًا ﴿٧٥﴾

75. Pra, le të luftojnë në rrugën e Allahut ata që këmbejnë jetën e kësaj bote me *ahiretin*. Ai që lufton në rrugën e Allahut dhe vritet ose triumfon, Ne pa dyshim do t'i japim një shpërblim madhështor.

فَلْيَقَاتِلْ فِي سَبِيلِ اللَّهِ الَّذِينَ يَشْرُونَ  
الْحَيَاةَ الدُّنْيَا بِالْآخِرَةِ ۗ وَمَنْ يُقَاتِلْ فِي  
سَبِيلِ اللَّهِ فَيُقْتَلْ أَوْ يَغْلِبْ فَسَوْفَ  
نُؤْتِيهِ أَجْرًا عَظِيمًا ﴿٧٦﴾

76. E çfarë ju ndodhi që nuk do të luftoni për rrugën e Allahut dhe për burrat, gratë dhe fëmijët e dobësuar, të cilët thonë: “O Zoti ynë! Na nxirr nga ky qytet, banorët e të cilit janë bërë mizorë; na dërgo prej Teje ndonjë mik; na dërgo prej Teje ndonjë ndihmës!”?!

وَمَا لَكُمْ لَأَ تَقَاتِلُونَ فِي سَبِيلِ اللَّهِ  
وَالْمُسْتَضْعَفِينَ مِنَ الرِّجَالِ وَالنِّسَاءِ  
وَالْوِلْدَانِ الَّذِينَ يَقُولُونَ رَبَّنَا أَخْرِجْنَا  
مِنْ هَذِهِ الْقَرْيَةِ الظَّالِمِ أَهْلُهَا ۗ  
وَاجْعَلْ لَنَا مِنْ لَدُنْكَ وَلِيًّا ۗ وَاجْعَلْ لَنَا  
مِنْ لَدُنْكَ نَصِيرًا ﴿٧٧﴾

77. Ata që besuan, luftojnë në rrugën e Allahut, kurse ata që mohuan, luftojnë në rrugën e djallit. Andaj, luftoni kundër miqve të djallit. Sigurisht, plani i djallit është i dobët.

الَّذِينَ آمَنُوا يُقَاتِلُونَ فِي سَبِيلِ اللَّهِ ۗ  
وَالَّذِينَ كَفَرُوا يُقَاتِلُونَ فِي سَبِيلِ  
الطَّاغُوتِ فَقَاتِلُوا أَوْلِيَاءَ الشَّيْطَانِ ۗ إِنَّ  
كَيْدَ الشَّيْطَانِ كَانَ ضَعِيفًا ﴿٧٨﴾



78. A nuk i ke vënë re ata, të cilëve u ishte thënë të hiqnin dorë, të falnin namazin dhe të jepnin zekatin?! Kur iu obligua lufta, sakaq, një grup prej tyre filloi të kishin frikë nga njerëzit, një frikë që duhet ta kishin nga Zoti, madje edhe më shumë. Dhe thanë: “O Zoti ynë! Përse na e obligove luftën? Përse nuk na e shtyve atë, duke na dhënë pak afat?” Thuaju: Pak është përfitimi i kësaj bote, kurse *ahireti* është i mirë për atë që ka druajtje. Nuk do t’ju bëhet padrejtësi asnjë fije.

79. Kudo që të gjendeni, do t’ju kapë vdekja, edhe sikur të gjendeni në kështjellat më të forta. Kur u vjen një e mirë, thonë se ajo është prej Allahut dhe kur i godet ndonjë e keqe, thonë se ajo është prej teje. Thuaju: “Çdo gjë është prej Allahut”. Çfarë i ka ndodhur këtij populli, (që) nuk arrijnë të kuptojnë qoftë edhe një fjalë?!

80. Një e mirë që të vjen, është nga Allahu dhe një e keqe që të godet, është prej vetes sate. Ty të kemi sjellë si të Dërguar për njerëzit dhe Allahu është i mjaftueshëm si Dëshmitar.

81. Ai që i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut. Ndërsa ai që kthehet mbrapsht, për të nuk të kemi dërguar ty si mbrojtës.<sup>14</sup>

أَلَمْ تَرَ إِلَى الَّذِينَ قِيلَ لَهُمْ كُفُّوا أَيْدِيَكُمْ وَأَقِيمُوا الصَّلَاةَ وَآتُوا الزَّكَاةَ فَلَمَّا كُتِبَ عَلَيْهِمُ الْقِتَالُ إِذَا فَرِيقٌ مِنْهُمْ يَخْشَوْنَ النَّاسَ كَخَشْيَةِ اللَّهِ أَوْ أَشَدَّ خَشْيَةً ۗ وَقَالُوا رَبَّنَا لِمَ كَتَبْتَ عَلَيْنَا الْقِتَالَ لَوْلَا أَخَّرْتَنَا إِلَىٰ أَجَلٍ قَرِيبٍ ۗ قُلْ مَتَاعُ الدُّنْيَا قَلِيلٌ ۗ وَالْآخِرَةُ خَيْرٌ لِّمَنِ اتَّقَىٰ وَلَا يُظْلَمُونَ فَتِيلًا ﴿٧٨﴾

أَيْنَ مَا تَكُونُوا يَدْرِكَكُمُ الْمَوْتُ وَلَوْ كُنْتُمْ فِي بُرُوجٍ مُّشِيدَةٍ ۗ وَإِنْ تُصِبْهُمْ حَسَنَةٌ يَقُولُوا هَذِهِ مِنْ عِنْدِ اللَّهِ ۗ وَإِنْ تُصِبْهُمْ سَيِّئَةٌ يَقُولُوا هَذِهِ مِنْ عِنْدِكَ ۗ قُلْ كُلٌّ مِّنْ عِنْدِ اللَّهِ ۗ فَمَالِ هَؤُلَاءِ الْقَوْمِ لَا يَكَادُونَ يَفْقَهُونَ حَدِيثًا ﴿٧٩﴾

مَا أَصَابَكَ مِنْ حَسَنَةٍ فَمِنَ اللَّهِ ۗ وَمَا أَصَابَكَ مِنْ سَيِّئَةٍ فَمِنَ نَفْسِكَ ۗ وَأَرْسَلْنَاكَ لِلنَّاسِ رَسُولًا ۗ وَكَفَىٰ بِاللَّهِ شَهِيدًا ﴿٨٠﴾

مَنْ يُطِيعِ الرَّسُولَ فَقَدْ أَطَاعَ اللَّهَ ۗ وَمَنْ تَوَلَّىٰ فَمَا أَرْسَلْنَاكَ عَلَيْهِمْ حَفِيظًا ﴿٨١﴾

14. Ajetet 79-81: Hipokritët brenda besimtarëve kur shohin ndonjë përparim, thonë – ky është grup i Allahut që patjetër do të përparojë. Por kur shohin ndonjë vështirësi, thonë – Profeti ose Kalifi ka gabuar dhe ne po e pësojmë gabimin e tij! Allahu u thotë – Kur ju mirësinë e

82. Ata thonë (veç me gojë) “bindje” dhe kur largohen prej teje, një grup i tyre gdhin natën duke folur ndryshe nga ajo që ke thënë. Allahu i shënon bisedat e tyre të natës. Prandaj, shmangiu atyre dhe mbështetu tek Allahu. Allahu është i mjaftueshëm si Mbrojtës.

وَيَقُولُونَ طَاعَةٌ فَإِذَا بَرَزُوا مِنْ  
عِنْدِكَ بَيَّتَ طَائِفَةٌ مِنْهُمْ غَيْرَ الَّذِي  
تَقُولُ ۗ وَاللَّهُ يَكْتُبُ مَا يُبَيِّنُونَ ۗ  
فَاعْرِضْ عَنْهُمْ وَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ ۗ وَكَفَى  
بِاللَّهِ وَكِيلًا ﴿٨٢﴾

83. A nuk e shqyrtojnë Kuranin?! Po të ishte ai nga dikush tjetër përveç Allahut, do të gjenin shumë kundërthënie në të.<sup>15</sup>

أَفَلَا يَتَدَبَّرُونَ الْقُرْآنَ ۗ وَلَوْ كَانَ مِنْ  
عِنْدِ غَيْرِ اللَّهِ لَوَجَدُوا فِيهِ اخْتِلَافًا  
كَثِيرًا ﴿٨٣﴾

84. Sa herë që u vjen ndonjë fjalë e paqes ose e frikës, ata e përhapin. Po ta sillnin atë tek i Dërguari ose tek autoritetet, të aftët prej tyre do ta kuptonin. Sikur të mos kishit bekimin e Allahut mbi vete dhe mëshirën e

وَإِذَا جَاءَهُمْ أَمْرٌ مِنَ الْأَمْنِ أَوِ الْخَوْفِ  
أَدَّعَوْا بِهٖ ۗ وَلَوْ رَدُّوهُ إِلَى الرَّسُولِ وَإِلَى  
أُولِي الْأَمْرِ مِنْهُمْ لَعَلِمَ الَّذِينَ  
يَسْتَبْطِنُونَهُ مِنْهُمْ ۗ وَلَوْ لَا فَضْلَ اللَّهِ

quani prej Allahut, nga ky këndvështrim, edhe vështirësia është po prej Allahut; andaj sjellja juaj që të mirën e quani prej Zotit dhe të keqen prej të Dërguarit, a nuk është me motivin që të pakësohet dashuria për të Dërguarin në zemrat e njerëzve?! Pastaj thotë – Por ka edhe një këndvështrim tjetër: Allahu i ka krijuar të gjitha forcat për të mirën e njeriut dhe kur njeriu i keqpërdor ato, përballet me pasoja. Në këtë aspekt, njeriu duhet t’i atribuojë të mirën Zotit dhe të keqen vetvetes, dhe jo Prijësit. Pra, ai duhet të thotë – Kjo humbje më ka ardhur për shkak të veprave të mia – dhe nuk duhet t’ia atribuojë humbjen dikujt tjetër. Kjo është përmendur si një parim i përgjithshëm, për këtë arsye ajeti i drejtohet të Dërguarit të Allahut i cili përfaqëson gjithë njerëzit. Kuptimi i ajetit nr. 80 kurrsesi nuk është që vështirësia vjen për shkak të të Dërguarit të Allahut. Ka shumë ajete në Kuran ku Zoti i drejtohet të Dërguarit të Tij, por nënkupton *umetin* (17:24). Kjo vërtetohet edhe nga ajeti nr. 81 që thotë qartazi se bindja ndaj të Dërguarit, është e barabartë me bindjen ndaj Allahut. Andaj, vështirësia që ju vjen për shkak të bindjes ndaj të Dërguarit, ju vjen prej caktimit të Zotit, dhe vështirësia që ju vjen për shkak të mosbindjes ndaj të Dërguarit ose për shkak se i Dërguari ju pranoi ndonjë kërkesë që ia bënit me këmbëngulje, ajo nuk mund t’i atribuohet të Dërguarit, por vetëm juve. Gjithashtu, këto ajete tregojnë se vështirësia që vjen për shkak të bindjes ndaj të Dërguarit, pra nga caktimi i Zotit, kurrsesi nuk sjell rezultate negative.

15. Ky ajete sjell argument të vërtetësisë së Kuranit duke thënë se nuk mund të gjesësh asnjë mospërputhje në ajetet e tij, edhe pse ai është zbritur përgjatë njëzet e tri viteve mbi një Profet të pashkolluar. Shpesh edhe njerëzit shumë të shkolluar harrojnë bisedat që mund të kenë bërë gjatë një periudhe të tillë. Si mundet atëherë për një njeri të pashkolluar të sajonte një libër që nuk ka kundërthënie?!

Tij, me përjashtim të një pakice, ju me siguri do ta ndiqnit djallin.

85. Pra, lufto në rrugën e Allahut. Ti ngarkohesh vetëm për veten tënde. Nxiti edhe besimtarët (për luftë). Mundet që Allahu ta zmbrapsë luftën e atyre që mohuan. Dhe Allahu është shumë i ashpër në luftë, shumë i ashpër edhe në ndëshkim.

86. Kush bën ndërmjetësim të mirë, do të marrë pjesë prej tij, dhe kush bën ndërmjetësim të keq, do të marrë barrë prej tij. Allahu është Fuqiplotë për çdo gjë.

87. Kur ju përshëndet dikush, kthejani me përshëndetje më të mirë se ajo, ose të njëjtë me të. Allahu është Llogaritës i çdo gjëje.

88. Allahu; nuk ka të adhurueshëm tjetër përveç Atij. Deri Ditën e Kiametit, Ai patjetër do (të vijojë) t'ju grumbullojë; nuk ka dyshim në të. E kush mund të jetë më i vërtetë në fjalë sesa Allahu?!

89. Çfarë ju ndodhi, pra, që jeni ndarë në dy grupe në çështjen e hipokritëve, kurse Allahu i ka mposhtur për shkak të asaj që ata kanë bërë?! A doni të udhëzoni atë që e ka cilësuar të devijuar Allahu?! Atij, që Allahu e cilëson të devijuar, kurrë nuk mund t'i gjesh rrugë.

عَلَيْكُمْ وَرَحْمَتُهُ لَا تَتَّبِعُهُمُ الشَّيْطَانُ إِلَّا قَلِيلًا ٨٥

فَقَاتِلْ فِي سَبِيلِ اللَّهِ لَا تُكَلِّفُ إِلَّا نَفْسَكَ  
وَحَرِّضِ الْمُؤْمِنِينَ عَسَى اللَّهُ أَنْ  
يُكَلِّفَ بَأْسَ الَّذِينَ كَفَرُوا وَاللَّهُ أَشَدُّ  
بَأْسًا وَأَشَدُّ تَنْكِيلًا ٨٥

مَنْ يُضْفَعْ شَفَاعَةٌ حَسَنَةٌ يَكُنْ لَهُ نَصِيبٌ  
مِنْهَا ۖ وَمَنْ يُضْفَعْ شَفَاعَةٌ سَيِّئَةٌ يَكُنْ  
لَهُ كِفْلٌ مِنْهَا ۗ وَكَانَ اللَّهُ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ  
مُقْتَبًا ٨٦

وَإِذَا حُجِّبْتُمْ بِتَحِيَّةٍ فَحَيُّوا بِأَحْسَنَ مِنْهَا  
أَوْ رُدُّوهَا ۗ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ  
حَسِيبًا ٨٧

اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ ۗ لِيَجْمَعَنَّكُمْ إِلَى  
يَوْمِ الْقِيَامَةِ لَا رَيْبَ فِيهِ ۗ وَمَنْ أَصْدَقُ  
بِعْدَ مِنَ اللَّهِ حَدِيثًا ٨٨

فَمَا لَكُمْ فِي الْمُنَافِقِينَ فِتْنَةٍ وَاللَّهُ  
أَرَكْسَهُمْ بِمَا كَسَبُوا ۗ أَلَمْ تَرَوْهُمْ أَن تَهْدُوا  
مَنْ أَضَلَّ اللَّهُ ۗ وَمَنْ يُضِلِلِ اللَّهُ فَلَنْ  
تَجِدَ لَهُ سَبِيلًا ٨٩

90. Duan që edhe ju të mohoni, ashtu siç ata kanë mohuar, që të bëheni njësoj. Prandaj, mos bëni shokë prej tyre, derisa ata të mërgojnë në rrugën e Allahut. E nëse ata kthehen mbrapsht, kapini dhe vritini, kudo që t'i gjeni. Mos bëni prej tyre as shokë e as ndihmës.<sup>16</sup>

91. Me përjashtim të atyre që vijnë nga një popull, me të cilin keni besëlidhje ose që vijnë tek ju në gjendje që e ndiejnë veten ngushtë për të luftuar me ju ose për të luftuar me popullin e vet. Sikur të donte Allahu, do t'u jepte pushtet mbi ju, atëherë, ata patjetër do të luftonin me ju. Prandaj, nëse ata do të mënjanojnë nga ju dhe nuk do të luftojnë me ju dhe do t'ju japin mesazhin e paqes, atëherë Allahu nuk ju ka dhënë asnjë justifikim kundër tyre.<sup>17</sup>

92. Do të gjeni edhe disa të tjerë që duan të kenë siguri nga ana juaj dhe siguri nga ana e popullit të tyre. Kurdoherë që ata shpuren në trazirë, bien përmbys në të. Ata nëse nuk mënjanojnë nga ju e nuk ju japin mesazhin e paqes dhe nuk tërhiqen, kapini, vritini kudo që t'i gjeni. Pikërisht kundër tyre ju kemi dhënë

وَدُّوا لَوْ تَكْفُرُونَ كَمَا كَفَرُوا فَتَكُونُونَ  
سَوَاءً فَلَا تَتَّخِذُوا مِنْهُمْ أَوْلِيَاءَ حَتَّى  
يُهَاجِرُوا فِي سَبِيلِ اللَّهِ فَإِنْ تَوَلَّوْا  
فَحُدُّوهُمْ وَاقْتُلُوهُمْ حَيْثُ وَجَدْتُمُوهُمْ  
وَلَا تَتَّخِذُوا مِنْهُمْ وُلِيًّا وَلَا نَصِيرًا ۝  
إِلَّا الَّذِينَ يَصِلُونَ إِلَى قَوْمٍ بَيْنَكُمْ  
وَبَيْنَهُمْ مِيثَاقٌ أَوْ جَاءُوكُمْ حَصِرَتْ  
صُدُورُهُمْ أَنْ يُقَاتِلُوكُمْ أَوْ يُقَاتِلُوا  
قَوْمَهُمْ ۖ وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ لَسَلَّطَهُمْ عَلَيْكُمْ  
فَلَقَاتَلُوكُمْ ۚ فَإِنْ اعْتَزَلُوكُمْ فَلَمْ  
يُقَاتِلُوكُمْ وَالْقُوا إِلَيْكُمْ السَّلْمَ ۖ فَمَا  
جَعَلَ اللَّهُ لَكُمْ عَلَيْهِمْ سَبِيلًا ۝

سَتَجِدُونَ الْآخَرِينَ يُرِيدُونَ أَنْ يَأْمَنُوكُمْ  
وَيَأْمَنُوا قَوْمَهُمْ ۖ كُلَّمَا رُزِّقُوا إِلَى الْفِتْنَةِ  
أُرْكِسُوا فِيهَا ۚ فَإِنْ لَمْ يَعْتَزِلُوكُمْ وَيُلْقُوا  
إِلَيْكُمْ السَّلْمَ وَيَكْفُرُوا أَيْدِيَهُمْ فَحُدُّوهُمْ  
وَاقْتُلُوهُمْ حَيْثُ تَقِفْتُمُوهُمْ ۖ وَأُولَئِكَ

16. Lexoni ajetin vijues.

17. Ajetet e mëparshme urdhërojnë për marrjen e masave kundër hipokritëve beduinë të fshatrave përreth Medinës. Ky ajet bën përjashtime për: (1) ata që kishin aleancë me ndonjë fis, i cili kishte aleancë me muslimanët; dhe (2) ata që erdhën në Medine dhe anonin nga Islami, ndonëse ishin ende në hezitim. Në fakt, Islami i kushton rëndësi të madhe traktateve, të shprehura apo të nënkuptuara, dhe në asnjë rast nuk toleron shkeljen e tyre. Ajeti gjithashtu tregon se ky lloj xhihadi lejohet vetëm kundër atyre që luftën e bëjnë të parët kundër muslimanëve. Për më shumë rreth temës së xhihadit, lexoni 25:53.

të drejtë të qartë.<sup>18</sup>

93. Nuk i lejohet besimtarit të vrasë besimtarin, veçse gabimisht. Ai që vret një besimtar gabimisht, të lirojë një besimtar të robëruar dhe t'i japë shpagimin e plotë familjes së tij, përveçse nëse ata e falin. Nëse ai ishte nga një popull armik juaji dhe ishte besimtar, (vrasësi) duhet të lirojë një besimtar të robëruar. Dhe nëse ai ishte nga një popull me të cilin keni besëlidhje, (vrasësi) t'i japë shpagimin e plotë familjes së tij (pra, të vrrarit) dhe të lirojë një besimtar të robëruar. Ai që nuk ka mundësi për këtë, i detyrohet agjërimi dy muaj radhazi. Kjo prej Allahut është (caktuar) si pendesë dhe Allahu është i Gjithëdijshtëm, i Urtë.

94. Dhe ai që vret një besimtar me dashje, shpërblimi i tij është xhehenemi. Në të do të jetojë gjatë. Allahu iu zemërua atij, e mallkoi dhe i përgatiti ndëshkim të rëndë.

95. O ju që besuat! Kur të udhëtoni në rrugën e Allahut, sigurohuni, dhe ai që ju jep *selam*, mos i thoni: “nuk je besimtar”. Doni pasurinë e jetës së kësaj bote, atëherë tek Allahu ka plot bekime. Kështu ishit ju më parë, pastaj Allahu ju ka bërë mirësi, prandaj, sigurohuni. Sigurisht, Allahu është i Gjithinformuar për atë që bëni.<sup>19</sup>

18. Lexoni ajetet 4:90-91.

19. Ky ajet është i qartë si drita e diellit që nuk duhet të merrni si armik kë të doni. Për të

جَعَلْنَا لَكُمْ عَلَيْهِمْ سُلْطٰنًا مُّبِينًا ﴿١٨﴾

وَمَا كَانَ لِمُؤْمِنٍ أَنْ يَفْتُلَ مُؤْمِنًا إِلَّا  
خَطَاً ۖ وَمَنْ قَتَلَ مُؤْمِنًا خَطَاً فَتَحْرِيرُ  
رَقَبَةٍ مُؤْمِنَةٍ وَادِيَةٌ مُسَلَّمَةٌ إِلَىٰ أَهْلِهَا  
إِلَّا أَنْ يَصَّدَّقُوا ۖ فَإِنْ كَانَ مِنْ قَوْمِ  
عَدُوِّ لَكُمْ وَهُوَ مُؤْمِنٌ فَتَحْرِيرُ رَقَبَةٍ  
مُّؤْمِنَةٍ ۖ وَإِنْ كَانَ مِنْ قَوْمٍ بَيْنَكُمْ  
وَبَيْنَهُمْ مِيثَاقٌ فَدِيَةٌ مُسَلَّمَةٌ إِلَىٰ أَهْلِهَا  
وَتَحْرِيرُ رَقَبَةٍ مُؤْمِنَةٍ ۖ فَمَنْ لَمْ يَجِدْ  
فِصْيَامَ شَهْرَيْنِ مُتَتَابِعَيْنِ تَوْبَةً مِّنَ  
اللَّهِ ۖ وَكَانَ اللَّهُ عَلِيمًا حَكِيمًا ﴿١٩﴾

وَمَنْ يَفْتُلْ مُؤْمِنًا مُّتَعَمِّدًا فَجَزَاؤُهُ جَهَنَّمُ  
خَالِدًا فِيهَا وَعَضَبَ اللَّهُ عَلَيْهِ وَعَلَنَاهُ  
وَإِعْدَلُهُ عَذَابًا عَظِيمًا ﴿١٩﴾

يٰۤأَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا ضَرَبْتُمْ فِي سَبِيلِ  
اللَّهِ فَتَبَيَّنُوا وَلَا تَقُولُوا لِمَنْ أَلْفَىٰ إِلَيْكُمْ  
السَّلَامَ لَسْتَ مُؤْمِنًا ۖ تَبْتَغُونَ عَرَضَ  
الْحَيٰوةِ الدُّنْيَا ۖ فَعِنْدَ اللَّهِ مَغَازِمٌ كَثِيرَةٌ ۖ  
كَذٰلِكَ كُنْتُمْ مِّن قَبْلُ ۖ فَمَنَّ اللَّهُ عَلَيْكُمْ  
فَتَبَيَّنُوا ۖ إِنَّ اللَّهَ كَانَ بِمَا تَعْمَلُونَ  
خَبِيرًا ﴿١٩﴾

96. Besimtarët që rrinë nëpër shtëpi pa pasur ndonjë sëmundje nuk janë të barabartë me ata që luftojnë në rrugën e Allahut me pasurinë dhe jetën e tyre. Allahu i ka ngritur në grada ata që luftojnë me pasurinë dhe jetën e tyre mbi ata që rrinë në shtëpi. Megjithatë, Allahu gjithkujt i ka premtuar mirësinë. Allahu i ka dalluar ata që luftojnë mbi ata që rrinë në shtëpi, për (të dhënë) një shpërblim madhor.

لَا يَسْتَوِي الْقَعْدُونَ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ عَيْرٍ  
أُولِي الضَّرَرِ وَالْمُجَاهِدُونَ فِي سَبِيلِ اللَّهِ  
بِأَمْوَالِهِمْ وَأَنْفُسِهِمْ فَضَّلَ اللَّهُ الْمُجَاهِدِينَ  
بِأَمْوَالِهِمْ وَأَنْفُسِهِمْ عَلَى الْقَعْدِينَ  
دَرَجَةً وَكُلًّا وَعَدَ اللَّهُ الْحَسْبَىٰ  
وَفَضَّلَ اللَّهُ الْمُجَاهِدِينَ عَلَى الْقَعْدِينَ  
أَجْرًا عَظِيمًا ﴿١٦﴾

97. (Këto) janë grada prej Tij, falje dhe mëshirë. Allahu me të vërtetë është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

دَرَجَاتٍ مِّنْهُ وَمَغْفِرَةً وَرَحْمَةً وَكَانَ اللَّهُ  
غَفُورًا رَّحِيمًا ﴿١٧﴾

98. Engjëjt, duke ua marrë shpirtin atyre që kanë shkelur veten e tyre, u thonë: “Në ç’gjendje ishit?” Ata u thonë: “Kemi qenë të dobët në tokë”. (Engjëjt) do t’u thonë: “A nuk ishte e gjerë toka e Allahut, që të mërgonit në të?!” Streha e tyre është xhehenemi. Eh sa destinacion i keq është ai!

إِنَّ الَّذِينَ تَوَفَّيْنَاهُمُ الْمَلَائِكَةَ ظَالِمًا لِّنَفْسِهِمْ  
قَالُوا فِيهِمْ كُنْتُمْ قَالُوا كُنَّا مُسْتَضْعَفِينَ  
فِي الْأَرْضِ قَالُوا أَلَمْ تَكُنْ أَرْضَ اللَّهِ  
وَاسِعَةً فَتُهَاجِرُوا فِيهَا قَالُوا لَيْسَ مَاؤُهُمْ  
جَهَنَّمُ وَسَاءَتْ مَصِيرًا ﴿١٨﴾

99. Përveç burrave të dobët, grave dhe fëmijëve, të cilët nuk kishin

إِلَّا الْمُسْتَضْعَفِينَ مِنَ الرِّجَالِ وَالنِّسَاءِ

dalluar dikë si joarmik, ju mjafton përsëritja e tij me “selam” (paqe). Është vërtet befasuese sesi “dijetarët” e devijuar të kësaj kohe, *selamit* të tjetrit i përgjigjen me dhunë. Gjykimi nga ana e njerëzve bëhet duke parë anën e jashtme, pasi brendinë e sheh vetëm Zoti. Andaj, askush nuk ka të drejtë të quajë dikë tjetër *qafir* (mohues; jomusliman) në kuptimin ligjor të fjalës, kur ai pohon duke thënë — unë jam musliman. Edhe i Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> tha: “Ai që falet si ne, *kiblen* tonë e merr si *kiblen* e vet dhe ha mishin që therim ne, është musliman dhe është në përgjegjësinë e Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Prandaj, mos mashtroni në lidhje me përgjegjësinë e Allahut” (Buhari, nr. 391). Ky ajlet parashtron një rast lufte, që është një rast ekstrem, dhe na thotë: nëse paragjykoni përsëritjen e tjetrit dhe e quani mashtrues, do të thotë se ju po i jepni përparësi botës materiale mbi *ahiretin* dhe mbi pëlqimin e Zotit, dhe do të quheni zhvatës të pasurisë së tij duke e cilësuar armik. Lexoni edhe 49:12.

zgjdhje dhe që nuk gjetën rrugë-dalje.

100. Për këta ka mundësi që Allahu t'i falë. Allahu është shumë Tolerant, shumë Falës.

101. Ai që mërgon në rrugën e Allahut, do të gjejë plot vendstrehime dhe begati në tokë. Dhe ai që del nga shtëpia e tij si mërgimtar drejt Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe e gjen vdekja (gjatë rrugës), shpërblimin e tij e ka përsipër Allahu. Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

102. Kur udhëtoni në tokë (duke luftuar), nuk është gjynah të shkurtoni namazin, nëse keni frikë se mohuesit do t'ju trazojnë. Pa dyshim, mohuesit janë armiq të tuaj të hapur.

103. Kur edhe ti je mes tyre (pra, mes besimtarëve) dhe i udhëheq në namaz, një grup prej tyre le të qëndrojë me ty dhe ata të mbajnë armët e tyre me vete. Kur të përfundojnë sexhden, le të kalojnë mbrapa jush dhe le të vijë grupi tjetër që nuk është falur. Tani, le të falen ata me ty dhe t'i mbajnë me vete mjetet e shpëtimit dhe armët e tyre. Ata që mohuan, duan që të rrini të shkujdesur ndaj armëve dhe mjeteve tuaja, që ata t'ju vërsulen përnjëherë. Nëse keni vështirësi për shkak të shiut ose jeni të sëmurë, nuk

وَالْوَالِدَانَ لَا يَنْطَعُونَ حِيلَةً وَلَا يَهْتَدُونَ  
سَبِيلًا ۝۱۰

فَأُولَٰئِكَ عَسَىٰ اللَّهُ أَنْ يَعْفُوَ عَنْهُمْ ۗ<sup>ط</sup>  
وَكَانَ اللَّهُ عَفْوًا غَفُورًا ۝۱۱

وَمَنْ يُهَاجِرْ فِي سَبِيلِ اللَّهِ يَجِدْ فِي الْأَرْضِ  
مَرْغَمًا كَثِيرًا وَسَعَةً ۗ وَمَنْ يَخْرُجْ مِنْ  
بَيْتِهِ مُهَاجِرًا إِلَى اللَّهِ وَرَسُولِهِ ثُمَّ  
يُدْرِكُهُ الْمَوْتُ فَقَدْ وَقَعَ أَجْرُهُ عَلَىٰ  
اللَّهِ ۗ وَكَانَ اللَّهُ غَفُورًا رَحِيمًا ۝۱۱

وَإِذَا صَرَبْتُمْ فِي الْأَرْضِ فَلَيْسَ عَلَيْكُمْ  
جُنَاحٌ أَنْ تَقْصُرُوا مِنَ الصَّلَاةِ ۗ إِنْ خِفْتُمْ  
أَنْ يَفْتِنَكُمْ الَّذِينَ كَفَرُوا ۗ إِنَّ الْكُفْرَيْنَ  
كَانُوا لَكُمْ عَدُوًّا مُّبِينًا ۝۱۲

وَإِذَا كُنْتُمْ فِيهِمْ فَأَقَمْتَ لَهُمُ الصَّلَاةَ  
فَلْتَقُمْ طَائِفَةٌ مِنْهُمْ مَعَكَ وَلْيَأْخُذُوا  
أَسْلِحَتَهُمْ ۗ فَإِذَا سَجَدُوا فَلْيَكُونُوا مِنْ  
وَرَائِكُمْ ۗ وَلْتَأْتِ طَائِفَةٌ أُخْرَىٰ لَمْ  
يُصَلُّوا فَلْيُصَلُّوا مَعَكَ وَلْيَأْخُذُوا حِذْرَهُمْ  
وَأَسْلِحَتَهُمْ ۗ وَذَٰلِكَ لِكَيْ تَعْلَمُوا  
عَنْ أَسْلِحَتِكُمْ وَأَمْتِعَتِكُمْ فَيَمِيلُونَ  
عَلَيْكُمْ مَيْلَةً وَاحِدَةً ۗ وَلَا جُنَاحَ عَلَيْكُمْ  
إِنْ كَانَ بِكُمْ أذىٌ مِنْ مَطَرٍ أَوْ كُنْتُمْ

bëni gjynah t'i lini armët; (sidoqoftë) merrni masa për shpëtimin tuaj. Allahu përnjëmend u ka përgatitur mohuesve ndëshkim poshtërues.

104. E kur të përfundoni namazin, kujtojeni Allahun në këmbë, ulur dhe (shtrirë) në ijët tuaja. Kur të jeni të sigurt, faleni namazin. Sigurisht, namazi u është obliguar besimtarëve në kohë të caktuar.<sup>20</sup>

105. Mos u tregoni të dobët në ndjekjen e popullit (kundërshtar). Nëse keni dhimbje, sigurisht që edhe ata kanë dhimbje. Ju shpresoni prej Allahut atë që ata nuk e shpresojnë. Allahu është i Gjithëdijshëm, i Urtë.

106. Pa dyshim, Ne të kemi zbritur Librin me vërtetësi, që të gjykosh njerëzit ashtu siç të ka mësuar Allahu. Dhe për të pabesët mos debato!

107. Kërkoji falje Allahut! Sigurisht, Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

108. Mosdebatopër ata që tradhtojnë veten e tyre. Pa dyshim, Allahu nuk do asnjë mëkatar tradhtar.

109. Ata fshihen nga njerëzit, por nuk fshihen dot nga Allahu. Ai është me ta kur kalojnë natën duke thënë fjalët që Ai nuk i pëlqen. Allahu i ka venë rreth punës që bëjnë ata.

مَرْضَىٰ أَنْ تَصْعَوْا ۖ اسْلِحَتْكُمْ ۚ وَخَذُوا  
حِذْرَكُمْ ۗ إِنَّ اللَّهَ أَعَدَّ لِلْكَافِرِينَ عَذَابًا  
مُّهِينًا ﴿١٠٤﴾

فَإِذَا قَضَيْتُمُ الصَّلَاةَ فَادْكُرُوا اللَّهَ قِيَمًا  
وَقُعُودًا ۖ وَعَلَىٰ جُوبِكُمْ ۚ فَإِذَا اطْمَأْنَنْتُمْ  
فَأَقِيمُوا الصَّلَاةَ ۚ إِنَّ الصَّلَاةَ كَانَتْ عَلَى  
الْمُؤْمِنِينَ كِتَابًا مَّوْقُوتًا ﴿١٠٥﴾

وَلَا تَهِنُوا فِي اتِّبَاعِ الْقَوْمِ ۗ إِنَّ تَكُونُوا  
تَأْلَمُونَ فَإِنَّهُمْ يَأْلَمُونَ كَمَا تَأْلَمُونَ ۚ  
وَتَرْجُونَ مِنَ اللَّهِ مَا لَا يَرْجُونَ ۗ وَكَانَ  
عَلَى اللَّهِ عِلْمًا حَكِيمًا ﴿١٠٦﴾

إِنَّا أَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ لِتَحْكُمَ  
بَيْنَ النَّاسِ بِمَا أَرَاكَ اللَّهُ ۗ وَلَا تَكُنْ  
لِللَّخَائِبِينَ حَصِيمًا ﴿١٠٧﴾

وَأَسْتَغْفِرِ اللَّهَ ۗ إِنَّ اللَّهَ كَانَ غَفُورًا  
رَحِيمًا ﴿١٠٨﴾

وَلَا تُجَادِلْ عَنِ الَّذِينَ يَخْتَانُونَ  
أَنْفُسَهُمْ ۗ إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ مَنْ كَانَ خَوَانًا  
أَثِيمًا ﴿١٠٩﴾

يَسْتَخْفُونَ مِنَ النَّاسِ وَلَا يَسْتَخْفُونَ مِنَ  
اللَّهِ وَهُوَ مَعَهُمْ إِذْ يُبَيِّنُونَ مَا لَا يَرْضَىٰ  
مِنَ الْقَوْلِ ۗ وَكَانَ اللَّهُ بِمَا يَعْمَلُونَ  
مُحِيطًا ﴿١١٠﴾

20. Lexoni 20:131.



110. Ja, jeni ju që debatoni për ta në jetën e kësaj bote. E kush do të debatojë për ta me Allahun Ditën e Kiametit, ose, kush do të jetë mbrojtësi i tyre?!

111. Kushdo që bën vepër të keqe ose shkel veten e tij, më pas i kërkon falje Allahut, do ta gjejë Allahun shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

112. Kushdo që bën mëkat, e bën kundër vetes së tij. Allahu është i Gjithëdijshëm, i Urtë.

113. Kushdo që bën gabim ose mëkat, pastaj atë ia vesh një të pafajshmi, merr mbi vete një shpifje dhe mëkat të hapur.

114. Sikur të mos kishe bekimin e Allahut mbi vete dhe mëshirën e Tij, një grup prej tyre kishte vendosur që domosdo të të devijonte, por ata nuk devijojnë tjetërkënd përveç vetvetes. Ata gjithsesi nuk mund të të dëmtojnë aspak. Allahu të ka zbritur Librin dhe urtësinë dhe të ka mësuar atë që nuk e dije. Bekimi i Allahut mbi ty është i madh.

115. Nuk ka mirësi në shumicën e pëshpëritjeve të tyre, me përjashtim të atij që urdhëron për lëmoshën ose për të drejtën ose për pajtimin midis njerëzve. Ai që e bën këtë duke dashur pëlqimin e Allahut, Ne me siguri do t'i japim atij një shpërblim madhor.

هَآأَنْتُمْ هَؤُلَاءِ جَدَلْتُمْ عَنْهُمْ فِي الْحَيَاةِ  
الدُّنْيَا فَمَنْ يُجَادِلِ اللَّهَ عَنْهُمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ  
أَمْ مَنْ يَكُونُ عَلَيْهِمْ وَكَيْلًا ﴿١١٠﴾

وَمَنْ يَعْمَلْ سُوءًا أَوْ يَظْلِمْ نَفْسَهُ ثُمَّ  
يَسْتَغْفِرِ اللَّهَ يَجِدِ اللَّهَ غَفُورًا رَحِيمًا ﴿١١١﴾

وَمَنْ يَكْسِبْ إِثْمًا فَإِنَّمَا يَكْسِبُهُ عَلَى نَفْسِهِ  
وَكَانَ اللَّهُ عَلِيمًا حَكِيمًا ﴿١١٢﴾

وَمَنْ يَكْسِبْ خَطِيئَةً أَوْ إِثْمًا ثُمَّ يَرْمِ بِهِ  
بَرِيءًا فَقَدْ اِحْتَمَلَ بُهْتَانًا وَإِثْمًا مُّبِينًا ﴿١١٣﴾

وَلَوْ لَا فَضْلُ اللَّهِ عَلَيْكَ وَرَحْمَتُهُ لَهَمَّتْ  
طَآئِفَةٌ مِنْهُمْ أَنْ يُضَلُّوكَ ۖ وَمَا يُضِلُّونَ  
إِلَّا أَنْفُسَهُمْ ۖ وَمَا يَصُرُّونَكَ مِنْ شَيْءٍ ۖ  
وَأَنْزَلَ اللَّهُ عَلَيْكَ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ  
وَعَلَّمَكَ مَا لَمْ تَكُنْ تَعْلَمُ ۖ وَكَانَ فَضْلُ  
اللَّهِ عَلَيْكَ عَظِيمًا ﴿١١٤﴾

لَا خَيْرَ فِي كَثِيرٍ مِّنْ نَّجْوَاهُمْ إِلَّا مَنْ  
أَمَرَ بِصَدَقَةٍ أَوْ مَعْرُوفٍ أَوْ إِصْلَاحٍ  
بَيْنَ النَّاسِ ۖ وَمَنْ يَفْعَلْ ذَلِكَ ابْتِغَاءَ  
مَرْضَاتِ اللَّهِ فَسَوْفَ نُؤْتِيهِ أَجْرًا عَظِيمًا ﴿١١٥﴾

116. Ai që kundërshton të Dërguarin pasi që i është bërë i qartë udhëzimi dhe ndjek (një rrugë) ndryshe nga rruga e besimtarëve, Ne e kthejmë atë atje ku ai është kthyer dhe e shpiem në xhehenem. Sa destinacion i keq është ai!

وَمَنْ يُشَاقِقِ الرَّسُولَ مِنْ بَعْدِ مَا تَبَيَّنَ لَهُ الْهُدَىٰ وَيَتَّبِعْ غَيْرَ سَبِيلِ الْمُؤْمِنِينَ نُوَلِّهِ مَا تَوَلَّىٰ وَنُصَلِّهِ جَهَنَّمَ ۗ وَسَاءَتْ مَصِيرًا ﴿١١٦﴾

117. Sigurisht, Allahu nuk fal që t'i atribuosh ortak Atij dhe përveç kësaj fal çdo gjë tjetër, për atë që do Ai. Ai që i atribuon ortak Allahut, ka humbur në devijim të thellë.

إِنَّ اللَّهَ لَا يَغْفِرُ أَنْ يُشْرَكَ بِهِ وَيَغْفِرُ مَا دُونَ ذَلِكَ لِمَنْ يَشَاءُ ۗ وَمَنْ يُشْرِكْ بِاللَّهِ فَقَدْ ضَلَّ ضَلَالًا بَعِيدًا ﴿١١٧﴾

118. Ata thërrasin në vend të Tij ca femra (idhuj). Ata thërrasin vetëm djallin rebel.

إِنْ يَدْعُونَ مِنْ دُونِهِ إِلَّا إِنثًا ۗ وَإِنْ يَدْعُونَ إِلَّا شَيْطَانًا مَرِيدًا ﴿١١٨﴾

119. Allahu e ka mallkuar, kurse ai (pra, djalli) tha: “Do të marr, patjetër, një pjesë të caktuar prej robërve të Tu;

لَعَنَهُ اللَّهُ ۗ وَقَالَ لَا أَخَذَنَّ مِنْ عِبَادِكَ نَاصِيًا مَفْرُوضًا ﴿١١٩﴾

120. dhe do t'i devijoj, do t'u ngjall shpresa dhe do t'i urdhëroj që ata t'u presin veshët bagëtive, gjithashtu, do t'i urdhëroj që ata të ndryshojnë krijimin e Allahut”. E kushdo që bën djallin shok, duke e lënë Allahun, ka pësuar humbje të qartë.<sup>21</sup>

وَلَا ضَلَّاهُمْ وَلَا مُنَبِّهَهُمْ وَلَا مَرْتَهُمْ فَلَيَبْتَغُنَّ آذَانَ الْإِنْعَامِ وَلَا مَرْتَهُمْ فَلَيَحْمِلُنَّ أَثْقَالَهُمْ وَلَا يَأْتِيَنَّ لَهُمْ الشِّتَاءُ وَلَا يَرْجِعُونَ ﴿١٢٠﴾

21. Ky ajet bëri një profeci të jashtëzakonshme, që, do të vinte një kohë, kur njeriu do të tentojë të bëjë ndryshime në krijimet e Allahut, siç ndodh sot, me anë të inxhinierisë gjenetike. Ngaqë kjo është një punë djallëzore, ndaj, Kurani thotë se njerëzit që do të përfshihen në këtë punë, do të pësojnë humbje të hapur dhe do të meritojnë edhe ndëshkimin e xhehenemit. Ndër profecitë e Kuranit në lidhje me shpikje të ndryshme të botës moderne, siç duket, kjo është e vetmja që ka edhe kamanë alarmi me vete. Kurani i Shenjtë ka plot profeci të tjera të kësaj natyre, por asnjëra prej tyre nuk bën alarm të tillë. Kjo tregon se inxhinieria gjenetike është e lejuar deri në masën ku krijimi i Allahut përdoret për qëllime mbrojtëse a shëndetësore. Nëse njeriu do ta përdorë atë për të bërë ndryshime në krijimin e Zotit, do të përballet me dëme kolosale. Sot një pjesë e shkencëtarëve gjithashtu e kundërshtojnë shfrytëzimin e kësaj shkence për të bërë ndryshime në krijimin e Zotit.

121. Djalli u premton dhe u jep shpresa dhe ai nuk u premton asgjë tjetër përveç mashtrimit.

122. Pikërisht vendi i këtyre është xhehenemi. Nuk do të gjejnë shpëtim prej tij.

123. Dhe ata që besuan dhe bënë të mira, do t'i shpiem në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Në to do të jetojnë gjithmonë. Premtimi i Allahut është i vërtetë. E kush mund të jetë më i vërtetë në fjalë sesa Allahu?!

124. Nuk do të bëhet (gyjkimi) as sipas shpresave tuaja e as sipas shpresave të ithtarëve të Librit. Kushdo që bën të keqe, do të dënohet për të dhe ai, përveç Allahut, nuk do të gjejë asnjë mik e asnjë ndihmës.

125. Dhe kushdo që bën të mira, qoftë mashkull qoftë femër, dhe është besimtar, do të pranohet në xhenet, dhe atij nuk do t'i bëhet padrejtësi asnjë fije.

126. Kush mund të jetë më i mirë në besim sesa ai që ia përkushton vëmendjen Allahut dhe që është edhe mirëbërës dhe ndjek grupin e Ibrahimit të nënshtruar (ndaj Zotit)?! Allahu e bëri mik Ibrahimin.

127. E Allahut është ajo që gjendet në qiej dhe ajo që gjendet në tokë. Dhe Allahu është Rrethuesi i çdo gjëje.

يَعِدُهُمْ وَيُمِيتُهُمْ<sup>ط</sup> وَمَا يَعِدُهُمُ الشَّيْطَانُ إِلَّا غُرُورًا ۝١٢١

أُولَئِكَ مَا لَهُمْ جَهَنَّمُ وَلَا يَجِدُونَ عَنْهَا مَحِيصًا ۝١٢٢

وَالَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ سُدَّ خَلْفَهُمُ جَنَّتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا أَبَدًا وَعَدَّ اللَّهُ حَقًّا وَمَنْ أَصْدَقُ مِنَ اللَّهِ قِيلًا ۝١٢٣

لَيْسَ بِأَمَانِيكُمْ وَلَا أَمَانِي أَهْلِ الْكِتَابِ<sup>ط</sup> مَنْ يَعْمَلْ سُوًّا يُجْزَ بِهِ<sup>ل</sup> وَلَا يَجِدْ لَهُ مِنْ دُونِ اللَّهِ وَلِيًّا وَلَا نَصِيرًا ۝١٢٤

وَمَنْ يَعْمَلْ مِنَ الصَّالِحَاتِ مِنْ ذَكَرٍ أَوْ أُنْثَىٰ وَهُوَ مُؤْمِنٌ فَأُولَئِكَ يَدْخُلُونَ الْجَنَّةَ وَلَا يُظْلَمُونَ نَقِيرًا ۝١٢٥

وَمَنْ أَحْسَنُ دِينًا مِمَّنْ أَسْلَمَ وَجْهَهُ لِلَّهِ وَهُوَ مُحْسِنٌ وَاتَّبَعَ مِلَّةَ إِبْرَاهِيمَ حَنِيفًا<sup>ط</sup> وَاتَّخَذَ اللَّهُ إِبْرَاهِيمَ خَلِيلًا ۝١٢٦

وَاللَّهُ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ<sup>ط</sup> وَكَانَ اللَّهُ بِكُلِّ شَيْءٍ مُّحِيطًا ۝١٢٧

128. Ata të kërkojnë gjykim në çështjen e grave. Thuaju: Allahu ju jep gjykim në çështjen e tyre dhe (ju tërheq vëmendjen për) atë që ju është lexuar para jush nga Libri në lidhje me gratë jetime, të cilave nuk ua jepni atë që është caktuar për to, ndërkohë, dëshironi të martoheni me to. Po ashtu, (Allahu ju jep gjykimin) në lidhje me fëmijët e dobët (e të pastrehë) dhe (ju porosit) të ngriheni me drejtësi në mbështetje të jetimëve. Çdo të mirë që bëni, Allahu është i Gjithëdijshëm për të.

129. Nëse ndonjë grua ka frikë prej bashkëshortit të saj për sjellje të dhunshme ose për shpërfillje, nuk bëjnë gjynah nëse pajtohen mes vete. Pajtimi është mbarësi. Njerëzit e kanë të ngulitur koprracinë. Nëse do të bëni mirësi dhe do të keni druajtje, Allahu pa dyshim është i Gjithinformuar për gjithçka që bëni.

130. Nuk do të keni mundësi të bëni drejtësi midis të gjitha grave, edhe sikur të dëshironi. (Por mund të bëni një gjë), pra, mos anoni tërësisht (vetëm nga njëra), duke e lënë tjetrën si të varur. Nëse përmirësoheni dhe keni druajtje, Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.<sup>22</sup>

وَيَسْتَفْتُونَكَ فِي النِّسَاءِ ۗ قُلِ اللَّهُ يُفْتِيكُمْ فِيهِنَّ ۗ وَمَا يُتْلَىٰ عَلَيْكُمْ فِي الْكِتَابِ فِي يَتَىٰ النِّسَاءِ الَّتِي لَا تُؤْتُونَهُنَّ مَا كُتِبَ لَهُنَّ وَ تَرْغَبُونَ ۗ أَلَنْ تُكْمَهُنَّ ۗ وَالْمَسْتَضْعَفِينَ مِنَ الْوُلْدَانِ ۗ وَأَلَنْ تَقُومُوا لِلْيَتَامَىٰ بِالْقِسْطِ ۗ وَمَا تَفْعَلُوا مِنْ خَيْرٍ فَإِنَّ اللَّهَ كَانَ بِهِ عَلِيمًا ۝١٢٨

وَإِنِ امْرَأَةٌ خَافَتْ مِنْ بَعْلِهَا نُشُورًا أَوْ إِعْرَاصًا فَلَا جُنَاحَ عَلَيْهِمَا أَنْ يُصْلِحَا بَيْنَهُمَا صُلْحًا وَالصُّلْحُ خَيْرٌ ۗ وَأُحْضِرَتِ الْأَنفُسَ الشُّحَّ ۗ وَإِنْ تُحْسِنُوا وَتَتَّقُوا فَإِنَّ اللَّهَ كَانَ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرًا ۝١٢٩

وَكُنْ تَسْطِيعُونَ أَنْ تُعْدِلُوا بَيْنَ النِّسَاءِ وَلَوْ حَرَصْتُمْ فَلَا تَمِيلُوا كُلَّ الْمِيلِ فَتَدْرُواهَا كَالْمِغْلَقَةِ ۗ وَإِنْ تَصْلِحُوا وَتَتَّقُوا فَإِنَّ اللَّهَ كَانَ غَفُورًا رَحِيمًا ۝١٣٠

22. Në rastet kur një burrë martohet me më shumë se një grua, nuk është e mundur për të, të ketë dashuri në të njëjtën masë me secilën, për sa kohë që dashuria ka lidhje me zemrën. Por, drejtësia është në dorën e njeriut. Për këtë arsye, Kurani i Shenjtë porosit fuqimisht që burri duhet të bëjë drejtësi me çdo grua, duke mos lënë asnjërën si të varur e të vetmuar. Lexoni edhe 4:4.

131. Nëse ata dy ndahen, Allahu do të bëjë të pavarur secilin me begatinë e Tij. Allahu është Zgjerues, i Urtë.

132. E Allahut është ajo që gjendet në qiej dhe ajo që gjendet në tokë. Ne kishim porositur ata të cilëve u ishte dhënë Libri para jush dhe po ashtu edhe ju, që: kini druajtje ndaj Allahut! Nëse do të mohoni, atëherë gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në tokë është e Allahut. Allahu është i Vetëmjaftueshëm, i Lavdishëm.

133. E Allahut është ajo që gjendet në qiej dhe ajo që gjendet në tokë dhe Allahu është i mjaftueshëm për të rregulluar çështjet.

134. Po të dojë Ai, mund t'ju zhdukë ju, o njerëz, dhe të sjellë të tjerë. Allahu është i Plotfuqishëm për këtë.

135. Ai që kërkon shpërblimin e kësaj bote, (le ta dijë se) tek Allahu ka edhe shpërblimin e kësaj bote, edhe të *ahiretit*. Allahu është Gjithëdhëgues, Gjithëshikues.

136. O ju që besuat! Bëhuni të qëndrueshëm në vendosjen e drejtësisë duke qenë dëshmitarë për hir të Allahut, edhe sikur ju duhet të dëshmoni kundër vetes suaj, kundër prindërve apo të afërmve. Qoftë i pasur, qoftë i varfër, Allahu është kujdestari më i mirë për të dy. Mos ndiqni dëshirat e t'i shmangeni drejtësisë! Nëse dredhoni fjalën ose shmangeni, Allahu është i

وَأَنْ يَتَفَرَّقَا يُعِْنِ اللَّهُ كُلاًّ مِّنْ سَعَتِهِ<sup>ط</sup>  
وَكَانَ اللَّهُ وَاسِعًا حَكِيمًا ﴿٣١﴾

وَاللَّهُ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ<sup>ط</sup>  
وَلَقَدْ وَصَّيْنَا الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ مِنْ  
قَبْلِكُمْ وَإِيَّاكُمْ أَنْ اتَّقُوا اللَّهَ<sup>ط</sup> وَأَنْ  
تَكْفُرُوا فَإِنَّ لِلَّهِ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي  
الْأَرْضِ<sup>ط</sup> وَكَانَ اللَّهُ غَنِيًّا حَمِيدًا ﴿٣٢﴾

وَاللَّهُ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ<sup>ط</sup>  
وَكَفَى بِاللَّهِ وَكِيلًا ﴿٣٣﴾

إِنْ يَشَأْ يُذْهِبْكُمْ أَيُّهَا النَّاسُ وَيَأْتِ  
بِآخَرِينَ<sup>ط</sup> وَكَانَ اللَّهُ عَلَىٰ ذَٰلِكَ قَدِيرًا ﴿٣٤﴾

مَنْ كَانَ يُرِيدْ ثَوَابَ الدُّنْيَا فَعِنْدَ اللَّهِ  
ثَوَابُ الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ<sup>ط</sup> وَكَانَ اللَّهُ سَمِيعًا  
بَصِيرًا ﴿٣٥﴾

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُونُوا قَوِّمِينَ  
بِالْقِسْطِ شُهَدَاءَ لِلَّهِ وَلَوْ عَلَىٰ أَنْفُسِكُمْ  
أَوِ الْوَالِدِينَ وَالْأَقْرَبِينَ<sup>ع</sup> إِنْ يَكُنْ غَنِيًّا  
أَوْ فَقِيرًا فَاللَّهُ أَوْلَىٰ بِهِمَا<sup>ف</sup> فَلَا تَتَّبِعُوا  
الْهَوَىٰ أَنْ تَعْدِلُوا<sup>ع</sup> وَإِنْ تَلَّوْا أَوْ تُعْرَضُوا

Gjithinformuar për atë që bëni.<sup>23</sup>

137. O ju që besuat! Besoni Allahun, të Dërguarin e Tij, Librin që është zbritur mbi të Dërguarin e Tij dhe Librin që është zbritur më përpara. Ai që mohon Allahun, engjëjt e Tij, Librat e Tij, të Dërguarit e Tij dhe Ditën e *Ahiretit*, është zhytur në devijim të thellë.<sup>24</sup>

138. Pa dyshim, ata që besuan, pastaj mohuan, sërish besuan dhe sërish mohuan dhe pastaj u shtuan në mohim, Allahu nuk do t'i falë dhe as nuk do t'u tregojë rrugën.<sup>25</sup>

139. Jepu “lajmin e mirë” hipokritëve që ata do të kenë ndëshkim të dhimbshëm.

140. Të cilët i marrin për shokë mohuesit në vend të besimtarëve. A kërkojnë nder pranë tyre? Pa dyshim, nderi, i gjithi është i Allahut.

141. Sigurisht, Ai ju ka zbritur

فَإِنَّ اللَّهَ كَانَ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرًا ﴿٣٧﴾  
يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا آمِنُوا بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ  
وَالْكِتَابِ الَّذِي نَزَّلَ عَلَى رَسُولِهِ وَالْكِتَابِ  
الَّذِي أُنزِلَ مِنْ قَبْلُ وَمَنْ يَكْفُرْ بِاللَّهِ  
وَمَلَائِكَتِهِ وَكُتُبِهِ وَرُسُلِهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ  
فَقَدْ ضَلَّ ضَلَالًا بَعِيدًا ﴿٣٨﴾

إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا ثُمَّ كَفَرُوا ثُمَّ آمَنُوا ثُمَّ  
كَفَرُوا ثُمَّ أَزْدَادُوا كُفْرًا لَمْ يَكُنِ اللَّهُ  
لِيَعْفِرْ لَهُمْ وَلَا لِيَهْدِيَهُمْ سَبِيلًا ﴿٣٩﴾

بَشِيرِ الْمُنْفِقِينَ بَأَنَّ لَهُمْ عَذَابًا أَلِيمًا ﴿٤٠﴾

الَّذِينَ يَتَّخِذُونَ الْكَافِرِينَ أَوْلِيَاءَ مِنْ  
دُونِ الْمُؤْمِنِينَ أَلَيْسَ عِنْدَهُمُ الْعِزَّةُ  
فَإِنَّ الْعِزَّةَ لِلَّهِ جَمِيعًا ﴿٤١﴾

وَقَدْ نَزَّلَ عَلَيْكُمْ فِي الْكِتَابِ أَنْ إِذَا

23. Ky ajet na porositi të zbatojmë mësimin e drejtësisë që jep Kurani edhe gjatë dëshimit. Pra, dëshmitari e ka për detyrë të dëshmojë me drejtësi, qoftë kundër vetes apo kundër njerëzve të tij të dashur. Lexoni edhe 5:9.

24. Njëherë Profeti<sup>savs</sup> ishte ulur përjashta me sahabët e tij, ndërkohë erdhi një njeri dhe e pyeti – Çfarë është besimi? – Të besosh në Allah, në engjëjt e Tij, në takimin me Të, në të Dërguarit e Tij dhe në ringjalljen pas vdekjes – iu përgjigj Profeti<sup>savs</sup>. Më pas, ai e pyeti – Çfarë është Islami? dhe Profeti<sup>savs</sup> i shpjegoi edhe Islamën dhe disa gjëra të tjera të rëndësishme. Pastaj ai u çua dhe u largua. Profeti<sup>savs</sup> u tha sahabëve – Shkoni dhe thirrni prapë, por aty nuk kishte njeri. Profeti<sup>savs</sup> tha – Ky ishte Xhibraili, i cili erdhi për t’ua mësuar njerëzve fenë e tyre (Buhari, nr. 50).

25. Ky ajet hedh poshtë bindjen se ‘renegati (apostati) duhet të dënohet me vdekje’. Kështu, ajeti thotë se nëse dikush kthehet nga besimi, pastaj prapë e pranon besimin, sërish kthehet nga besimi, sërish e pranon, vendimi për të i takon Allahut të Madhërishëm dhe po të vdesë ai në gjendje mohimi, do të futet në xhehenem. Për apostatin, nëse do të ishte dënimi me vdekje, si mund të lindte pyetja për besimin dhe mohimin e tij kaq shumë herë?!

(urdhrin) në Libër, që kur dëgjoni se po mohohen ajetet e Allahut ose po përqeshen, mos u ulni pranë atyre (që i mohojnë dhe i përqeshin ato), derisa nuk merren me ndonjë bisedë tjetër. Përndryshe, edhe ju do të jeni si ata. Allahu do t'i mbledhë të gjithë hipokritët dhe mohuesit në xhehenem.

142. Të cilët presin (lajme të këqija) për ju. Pra, kur keni fitore nga Allahu, ata (ju) thonë: “A nuk ishim me ju?!” dhe kur mohuesit gëzojnë ndonjë pjesë (në fitore), atyre u thonë: “A nuk ju kemi mbizotëruar (më parë) dhe a nuk ju kemi shpëtuar nga besimtarët?” Atëherë, Allahu do të gjykojë mes jush Ditën e Kiametit. Dhe Allahu nuk do t'u lëshojë rrugën aspak mohuesve kundër besimtarëve.

143. Hipokritët bëjnë mashtrim me Allahun, por Ai ata i vë në mashtrim. E kur ata ngrihen për namaz, ngrihen përtacë. Shtiren para njerëzve dhe shumë pak e kujtojnë Allahun.

144. Qëndrojnë në mëdyshje. Nuk shkojnë as te këta dhe as tek ata. Dhe atij, që Allahu e cilëson të devijuar, kurrë nuk mund t'i gjesh rrugë.

145. O ju që besuat! Mos i bëni miq mohuesit në vend të besimtarëve! Mos doni t'i jepni Allahut argument të qartë kundër vetvetes?!<sup>26</sup>

سَمِعْتُمْ آيَاتِ اللَّهِ يُكْفَرُ بِهَا وَيُسْتَهْرَأُ بِهَا  
فَلَا تَقْعُدُوا مَعَهُمْ حَتَّى يَخُوضُوا فِي  
حَدِيثِ غَيْرِهِ ۗ إِنَّكُمْ إِذَا مَاتُمْ ط إِنَّ اللَّهَ  
جَامِعُ الْمُنْفِقِينَ وَالْكَافِرِينَ فِي جَهَنَّمَ  
جَمِيعًا ۝١٤٢

الَّذِينَ يَتَرَبَّصُونَ بِكُمْ ۚ فَإِنْ كَانَ لَكُمْ  
فَتْحٌ مِّنَ اللَّهِ قَالُوا أَلَمْ نَكُنْ مَعَكُمْ ۗ  
وَإِنْ كَانَ لِلْكَافِرِينَ نَصِيبٌ ۙ قَالُوا أَلَمْ  
نَسْتَعِذْ عَلَيْكُمْ وَنَمْنَعُكُم مِّنَ الْمُؤْمِنِينَ ط  
فَاللَّهُ يَحْكُمُ بَيْنَكُمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ ۖ وَلَنْ  
يَجْعَلَ اللَّهُ لِلْكَافِرِينَ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ  
سَبِيلًا ۝١٤٣

إِنَّ الْمُنْفِقِينَ يُخَدِعُونَ اللَّهَ وَهُوَ  
خَادِعُهُمْ ۚ وَإِذَا قَامُوا إِلَى الصَّلَاةِ قَامُوا  
كَسَالَى ۙ يُرَاءُونَ النَّاسَ وَلَا يَذْكُرُونَ  
اللَّهَ إِلَّا قَلِيلًا ۝١٤٤

مُدْبِدِينَ بَيْنَ ذَلِكَ ۗ لَا إِلَى هَؤُلَاءِ وَلَا  
إِلَى هَؤُلَاءِ ط وَمَنْ يُضِلِلِ اللَّهُ فَلَنْ تَجِدَ لَهُ  
سَبِيلًا ۝١٤٥

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَتَّخِذُوا الْكَافِرِينَ  
أَوْلِيَاءَ مِنْ دُونِ الْمُؤْمِنِينَ ط أَتُرِيدُونَ  
أَنْ تَجْعَلُوا لِلَّهِ عَلَيْكُمْ سُلْطَانًا مُّبِينًا ۝١٤٦

26. Lexoni 60:9-10; 3:119-121.

146. Sigurisht, hipokritët do të jenë në thellësinë më të madhe të zjarrit, dhe ti nuk mund të gjesh dot ndonjë ndihmës për ta.<sup>27</sup>

147. Përveç atyre që u penduan, u përmirësuan, kapën fuqimisht Allahun dhe e pastruan besimin e tyre për Allahun. Të tillët do të jenë me besimtarët, dhe Allahu së shpejti do t'u japë besimtarëve një shpërblim madhor.

148. Çfarë do të bëjë Allahu duke ju ndëshkuar, nëse do ta falënderoni dhe do ta besoni?! Allahu është Mirënjohës, i Gjithëdijshëm.

Xhuzi 6

149. Allahu nuk do që të thuhet hapur e keqja; përjashtim bën për atë, të cilit i është bërë mizori. Allahu është Gjithëdëgjues, i Gjithëdijshëm.

150. Të tregoni një të mirë apo ta fshihni, apo të toleroni ndonjë të keqe, (dijeni se) Allahu është shumë Tolerant, Fuqiplotë.

151. Sigurisht, ata që mohojnë Allahun dhe të Dërguarit e Tij dhe dëshirojnë të bëjnë ndarje midis Allahut dhe të Dërguarve të Tij dhe thonë: “Disa i pranojmë dhe disa i mohojmë” dhe dëshirojnë të marrin një rrugë në mes kësaj,

إِنَّ الْمُنْفِقِينَ فِي الذَّرِكِ الْأَسْفَلِ مِنَ  
النَّارِ ۗ وَلَنْ تَجِدَ لَهُمْ نَصِيرًا ﴿٤٦﴾

إِلَّا الَّذِينَ تَابُوا وَأَصْلَحُوا وَاعْتَصَمُوا  
بِاللَّهِ وَأَخْلَصُوا دِينَهُمْ لِلَّهِ فَأُولَٰئِكَ مَعَ  
الْمُؤْمِنِينَ ۗ وَسَوْفَ يُؤْتِ اللَّهُ الْمُؤْمِنِينَ  
أَجْرًا عَظِيمًا ﴿٤٧﴾

مَا يَفْعَلُ اللَّهُ بِعَذَابِكُمْ إِن شَكَرْتُمْ  
وَأَمْتُمْ ۗ وَكَانَ اللَّهُ شَاكِرًا عَلِيمًا ﴿٤٨﴾

لَا يَحِبُّ اللَّهُ الْجَهْرَ بِالسُّوِّءِ مِنَ الْقَوْلِ  
إِلَّا مَنْ ظَلَمَ ۗ وَكَانَ اللَّهُ سَمِيعًا  
عَلِيمًا ﴿٤٩﴾

إِنْ تُبْدُوا خَيْرًا أَوْ تُخْفُوهُ أَوْ تَعْفُوا عَنْ  
سُوِّءٍ فَإِنَّ اللَّهَ كَانَ عَفْوًا قَدِيرًا ﴿٥٠﴾

إِنَّ الَّذِينَ يَكْفُرُونَ بِاللَّهِ وَرُسُلِهِ  
وَ يُرِيدُونَ أَنْ يُفَرِّقُوا بَيْنَ اللَّهِ وَرُسُلِهِ  
وَيَقُولُونَ نُؤْمِنُ بِبَعْضٍ وَنَكْفُرُ بِبَعْضٍ  
وَيُرِيدُونَ أَنْ يُتَّخَذُوا بَيْنَ ذَلِكَ سَبِيلًا ﴿٥١﴾

27. Hipokritët janë më të këqij se mohuesit, sepse mohuesi ka guximin dhe forcën vendimore, prandaj kundërshton dhe tregon hapur mendimin e vet. Por hipokriti është frikacak, nuk ka forcë vendimore dhe e fsheh të vërtetën. Po kështu, një musliman që pretendon të jetë edhe dijetar, edhe i dëlirë, nëse provohet të jetë hipokrit në sjelljen e tij, për të nuk ka poshtërim më të madh se kjo. Andaj, hipokriti është në gjendjen më të ulët.



152. pikërisht ata janë mohues të vërtetë. Ne kemi përgatitur ndëshkim poshtërues për mohuesit.

أُولَٰئِكَ هُمُ الْكٰفِرُونَ حَقًّا ۖ وَأَعْتَدْنَا  
لِلْكَٰفِرِينَ عَذَابًا مُّهِينًا ﴿١٥٢﴾

153. Dhe ata që besuan Allahun dhe të Dërguarit e Tij dhe nuk bëjnë ndarje midis asnjërit prej tyre, pikërisht atyre Ai do t'u japë shpërblimet e tyre. Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.<sup>28</sup>

وَالَّذِينَ آمَنُوا بِاللّٰهِ وَرُسُلِهِ ۖ وَلَمْ يُفَرِّقُوا  
بَيْنَ أَحَدٍ مِنْهُمْ ۚ أُولَٰئِكَ سَوْفَ يُؤْتِيهِمْ  
مِنْ أَجْرِهِمْ ۗ وَكَانَ اللّٰهُ غَفُورًا رَّحِيمًا ﴿١٥٣﴾

154. Ithtarët e Librit të kërkojnë që atyre t'u zbresësh ndonjë libër prej qiellit. Ata i kërkuan Musait gjërat akoma më të mëdha. Pra, i thanë: “Na trego Allahun drejtpërdrejt!” I zuri vetëtimja për shkak të padrejtësisë së tyre. Më pas ata e morën viçin (si Zot), pasi u kishin ardhur shenjat e qarta. Ne prapë i toleruam dhe Musait i dhamë argument të qartë.

يَسْأَلُكَ أَهْلُ الْكِتَابِ أَنْ تُنزِلَ عَلَيْهِمْ  
كِتَابًا مِّنَ السَّمَاءِ فَقَدْ سَأَلُوا مُوسَىٰ أَكْبَرَ  
مِنَ ذَلِكَ فَقَالُوا أَرِنَا اللّٰهَ جَهْرَةً  
فَأَخَذْتَهُمُ الصَّعِقَةَ يُظْلَمُونَ ۖ ثُمَّ اتَّخَذُوا  
الْجِبْلَ مِنْ بَعْدِ مَا جَاءَهُمْ الْبَيِّنَاتُ فَعَفَوْنَا  
عَنْ ذَلِكَ ۖ وَآتَيْنَا مُوسَىٰ سُلْطٰنًا مُّبِينًا ﴿١٥٤﴾

155. Dhe për shkak të besëlidhjes së tyre, Ne ngritëm Turin mbi ta<sup>29</sup> dhe u thamë: “Hyni të nënshtuar në këtë derë!”; gjithashtu u thamë: “Mos e teproni në çështjen e *Sabatit!*” Ne u morëm besëlidhje të fortë.

وَرَفَعْنَا فَوْقَهُمُ الصُّورَ بِمِثَاقِهِمْ وَقُلْنَا  
لَهُمْ ادْخُلُوا الْبَابَ سُجَّدًا ۖ وَقُلْنَا لَهُمْ لَا  
تَعْدُوا فِي السَّبْتِ ۖ وَآخَذْنَا مِنْهُمْ مِّثَاقًا  
عَلِيًّا ﴿١٥٥﴾

28. Ajetet 151-153: Në këto ajete Zoti e lidhi besimin në Të me besimin edhe në të dërguarit e Tij. Pra, nuk mund të bësh ndarje mes Zotit dhe të dërguarve të Tij. Zoti e ka gdhendur te njeriu aftësinë për të pranuar Njëshmërinë e Zotit, por këtë mund ta krahasonim me shkëndijën që “gjendet” në gur. Profeti, pra i dërguari i Zotit është si strall që e godet gurin dhe ndez shkëndijën e Njëshmërisë së Zotit në zemrën e njeriut. Kështu që, kur njëshmëria e Zotit zhduket nga ndonjë vend, vetëm i dërguari i Tij e risjell atë. Zoti është një thesar i fshehtë dhe Ai e zbulon Vetën përmes profetit. Andaj, besimi në të dy është i domosdoshëm. Veç kësaj, ajetet 151-152 hedhin poshtë ideologjinë e atyre që i mohojnë kategorikisht *hadithet*, sepse flasin për njerëzit që tentojnë të bëjnë ndarje midis fjalës së Allahut dhe asaj të të Dërguarit, madje, që e refuzojnë fjalën e të Dërguarit. Ajeti 153 e përforcon edhe më shumë idenë se ata që vërtet besojnë Allahun dhe të Dërguarin, nuk bëjnë asnjë ndarje midis thënieve të Allahut dhe të të Dërguarit. Lexoni 6:165.

29. Lexoni 2:64.

156. Pra, për shkak të shkeljes së besëlidhjes së tyre, të mohimit të tyre ndaj ajeteve të Allahut, të kundërshtimit të tyre të ashpër pa të drejtë ndaj Profetëve dhe të fjalës së tyre: “Zemrat tona janë (bërë) perde” – por e vërteta është se Allahu ua vulosi (zemrat) për shkak të mohimit të tyre, andaj, ata nuk do të besojnë, veçse pak –,

157. dhe për shkak të mohimit të tyre dhe për shkak të fjalës së tyre (që përbën) një shpifje të madhe mbi Merjemen,

158. dhe për shkak të fjalës së tyre: “Ne me siguri e kemi vranë Mesihun, Isain birin e Merjemes, të Dërguarin e Allahut”. Ata as nuk e vranë dhe as nuk e kryqëzuan atë,<sup>30</sup> por ashtu u është dukur atyre.<sup>31</sup> Ata që patën kundërshtime në lidhje me të, me siguri ranë në dyshim për të. Përveç ndjekjes së hamendjes, ata nuk kanë aspak dije rreth tij. Ata me siguri nuk e vranë dot atë;

فَمَا نَقُضِهِمْ مِيثَاقَهُمْ وَكُفِّرِهِمْ بِآيَاتِ اللَّهِ  
وَقَاتِلِهِمُ الْأَنْبِيَاءَ بَعِيرِ حَقٍّ وَقَوْلِهِمْ قُلُوبُنَا  
غُلْفٌ ۖ بَلْ طَبَعَ اللَّهُ عَلَيْهَا بِكُفْرِهِمْ فَلَا  
يُؤْمِنُونَ إِلَّا قَلِيلًا ﴿٥٦﴾

وَكَفِّرِهِمْ وَقَوْلِهِمْ عَلَى مَرْيَمَ بُهْتَانًا  
عَظِيمًا ﴿٥٧﴾

وَقَوْلِهِمْ إِنَّا قَتَلْنَا الْمَسِيحَ عِيسَى ابْنَ  
مَرْيَمَ رَسُولَ اللَّهِ ۚ وَمَا قَتَلُوهُ وَمَا  
صَلَبُوهُ وَلَكِنْ شُبِّهَ لَهُمْ ۖ وَإِنَّ الَّذِينَ  
احْتَلَفُوا فِيهِ لَفِي شَكٍّ مِّنْهُ ۖ مَا لَهُمْ بِهِ  
مِنْ عِلْمٍ إِلَّا ابْتِغَاءَ الظَّنِّ ۚ وَمَا قَتَلُوهُ  
يَقِينًا ﴿٥٨﴾

30. Fjala “salebe” nuk domethënë vetëm të rrijë i varur në kryq e pastaj të hiqet, por do të thotë të arrihet qëllimi i kryqëzimit, pra, personi të ekzekutohet me anë të kryqëzimit. Pra, të vritet në kryq (Mufredat). Shumë njerëz mund të varen në kryq dhe të nxirren të gjallë prej tij dhe asnjëherë nuk mund të thuhet se ata u kryqëzuan. Në fund të ajetit, edhe njëherë është theksuar si përfundim, se ata nuk kanë qenë të suksesshëm për ta vranë Mesihun.

31. Fjalët “ashtu u është dukur atyre” disa dijetarë i keqinterpretojnë duke thënë se dikush tjetër u shndërrua në Mesih dhe ai u kryqëzua në vend të tij, por frazeologjia e gjuhës arabe nuk e lejon një kuptim të tillë, sepse duhej të përmendej edhe personi që iu përngjau kaq shumë Mesihut, sa që u bë identik si ai. Fjalët “ashtu u është dukur atyre” qartazi tregojnë se autorët e kimit ranë në dyshime dhe e gjithë çështja iu bë e dyshimtë. Hazret Imam Raziu<sup>a</sup>, në komentim të këtij ajeti shkruan: “... ata ranë në dyshim” (Razi, nën ajetin 4:157).

159. por Allahu e ngriti drejt Vetes.<sup>32</sup>  
Dhe Allahu është Mbizotërues, i  
Urtë.<sup>33</sup>

بَلْ رَفَعَهُ اللَّهُ إِلَيْهِ ۗ وَكَانَ اللَّهُ عَزِيزًا  
حَكِيمًا ﴿١٥٩﴾

32. Ajeti nr. 158 jep përgjigjen e të dyja akuzave të ngritura nga judenjtë. Zoti i Madhërishëm së pari deklaroi se *Hazret Isai* dhe *Hazret Merjemja*, paqja qoftë mbi të dy, ishin të virtytshëm dhe se akuzat e judenjve për karakterin e *Hazret Merjemes*<sup>as</sup> është vetëm një shpifje shumë e rëndë (ajeti 157). Dhe së dyti, *Isai*<sup>as</sup> nuk ndërroi jetë në kryq, por judenjtë kështu kujtuan se ai kishte vdekur, andaj, si i tillë, ai nuk është i mallkuar, por i pranuar te Zoti i Madhërishëm, dhe Zoti e lartësoi atë siç i lartëson profetët e tjerë. E gjithë grindja e hebrenjve ishte për karakterin dhe për moslartësimin shpirtëror të *Hazret Isait*<sup>as</sup>, dhe Zoti i hodhi poshtë të dyja akuzat e tyre. Këtu nuk flitet asgjë për ngritjen fizike të tij. Fjalët “*as nuk e vranë dhe as nuk e kryqëzuan*” nuk pohojnë aspak se ai nuk ka vdekur. Nuk janë këto dy forma si të vetmet për vdekjen e njeriut. Këto fjalë hedhin poshtë pretendimin e judenjve që Jezusi (*Isai*)<sup>as</sup> të ishte i mallkuar, me pretendimin se vdiq në kryq, pasi kjo mënyrë ekzekutimi konsiderohej e mallkuar, sidomos për një person që pretendonte të ishte profet i Zotit (Bibla, Ligji i Përtërirë 21:23). Kështu që, judenjtë e pandehnin Jezusin<sup>as</sup> si të mallkuar, e jo të pranuar të Zotit. Andaj, Zoti përmes Kuranit provoi që Jezusi nuk vdiq në kryq. Fjalët “*por ashtu u është dukur atyre*” e mbështesin edhe më shumë këtë argument, pra me fjalë të tjera, Zoti thotë - ai ishte i gjallë, judenjtë e kujtuan si të vdekur. Dhe për sa kohë që nuk vdiq në kryq, ai nuk quhet i mallkuar, përkundrazi, “*Zoti e ngriti atë drejt Vetes*”, që do të thotë se e ka lartësuar siç i lartëson Profetët e Tij të pranuar. Sipas Kuranit, udhëtimi ose ngritja e robit drejt Zotit nuk bëhet fizikisht por shpirtërisht. Shih: 51:51; 7:176-177; 19:57-58; 89:29-31; 38:51. E gjithë ngjarja e kryqëzimit nëse analizohet qoftë me të dhënat që gjenden sot në Dhiatën e Re, vërtetohet se Jezusi<sup>as</sup> u vu në kryq, por shpëtoi nga kryqëzimi dhe pati jetë të gjatë. Përveç kësaj, besimi se *Isai*<sup>as</sup> është ende gjallë, bie ndesh me një sërë ajetesh të qarta të Kuranit të Shenjtë, si 5:116-118; 3:56; 3:145; 21:9; etj..

33. Të krishterët e sotëm besojnë se Krishti vdiq në kryq për të patur një vdekje të mallkuar (Galatasve 3:13), dhe për t’ua marrë mëkatet atyre që i besojnë atij. Kryqëzimi ishte një lloj pushkatimi sa i dhimbshëm, aq edhe poshtëruar. Historia dëshmon se të kryqëzuarit liheshin për ditë të tëra edhe pas vdekjes së tyre. Judenjtë donin me çdo kusht që Jezusi të kryqëzohej, pra të ekzekutohej, që të provohej se ai nuk qe i dërguari i Zotit, por qe një i mallkuar, *ma’adhallah!* Por faktet biblike vërtetojnë se Jezusi nuk vdiq në kryq, por shpëtoi nga kryqëzimi, siç e pohon Kurani i Shenjtë. Për ta shpëtuar robin e Vet, Zoti gërshtoi një plan të përsosur, kundër planit të judenjve: Zoti i jep Jezusit lajmin e sigurimit dhe të shpëtimit të tij, siç e kishte shpëtuar dikur edhe profetin Jona (Mateu 12:39-40). I jep mundësi Jezusit që të lutej tërë natën për shpëtimin e tij (Marku 14:36). Njofton gruan e Pilatit për pafajësinë e Jezusit nëpërmjet ëndrrës, pra, nëpërmjet mjetit të Tij të komunikimit (Mateu 27:19). I zgjon ndërgjegjen Pilatit për të bërë çmos për shpëtimin e Jezusit (Gjoni 18:38-40). Zoti bën që të zgjidhet pikërisht dita e premtë për kryqëzimin e Jezusit, në mënyrë që ai të qëndronte vetëm disa orë në kryq, sepse nga mbrëmja do të fillonte *sabati*. Kështu, sipas Biblës, Jezusi qëndroi në kryq vetëm 3 – 6 orë (Marku 15:25 dhe Mateu 27:46). Pilati tregohet dyshues nëse Jezusi me të vërtetë ka vdekur (Marku 15:44). Jezusit nuk ia thyen kokat, madje kur një ushtar i ngul shtizën në brinjë, menjëherë i del gjak dhe ujë (Gjoni 19:32-34), që në fakt, janë shenja jete dhe jo vdekjeje. Zoti shkakton tërmet e stuhi nga qielli (Mateu 27:51). Ai i frymëzon Jozefin dhe Nikodemën për të planifikuar marrjen e Jezusit dhe kurimin e tij, të cilët e vizitojnë dhe ia çojnë *mirrë* dhe *aloe* në një sasi prej 33 kg (Gjoni 19:39). Barnat mirrë dhe aloe përdoren

160. Nuk do të ketë asnjë (palë) nga ithtarët e Librit, përveçse do të besojë në të, përpara vdekjes së tij.<sup>34</sup> Dhe Ditën e Kiametit, ai do të jetë dëshmitar mbi ta.

وَأَنَّ مِنْ أَهْلِ الْكِتَابِ إِلَّا لِيُؤْمِنُوا بِهِ  
قَبْلَ مَوْتِهِ ۗ وَيَوْمَ الْقِيَامَةِ يَكُونُ عَلَيْهِمْ  
شَهِدًا ۝

161. Pra, për shkak të mizorisë së atyre që qenë hebrenj dhe për shkak të të penguarit të shpeshtë të tyre nga rruga e Allahut, Ne ua ndaluan gjërat e mira që ishin të lejuara për ta (deri më parë).

فَبُطِّلِمُ مِنَ الَّذِينَ هَادُوا حَرَمًا عَلَيْهِمْ  
طَيِّبَاتٍ أُحِلَّتْ لَهُمْ وَ بَصَدَّيْهِمْ عَنْ  
سَبِيلِ اللَّهِ كَثِيرًا ۝

162. Dhe për shkak të mitmarrjes së tyre, edhe pse kjo u ishte ndaluar, dhe për shkak të gllabërimit të pasurive të njerëzve padrejtësisht (i kemi ndëshkuar ata) Dhe për mohuesit nga ata, kemi përgatitur ndëshkim të dhimbshëm.

وَ أَخَذِهِمُ الرِّبَا وَقَدْ نُهُوا عَنْهُ وَأَكْلِهِمْ  
أَمْوَالَ النَّاسِ بِالْبَاطِلِ ۗ وَ أَعْتَدْنَا  
لِلْكَافِرِينَ مِنْهُمْ عَذَابًا أَلِيمًا ۝

dendur për kurimin e plagëve. Të gjitha këto fakte tregojnë bindshëm se armiqtë e Jezusit bënë planin e tyre, por edhe Zoti bëri një plan të Vet, dhe pikërisht plani i Zotit e shpëtoi Jezusin nga vdekja e mallkuar. U provua që Jezusi nuk qe i mallkuar, por i bekuar, i lartësuar dhe i ndihmuar nga Zoti i Madhërishtëm. Për të ditur se çfarë ndodhi me *Hazret Isain*<sup>as</sup>, pasi shpëtoi nga kryqëzimi, lexoni 23:51.

34. Fjalët “Nuk do të ketë asnjë nga ithtarët e Librit” mund të kenë dy kuptime: 1) “nuk do të ketë asnjë njeri nga ithtarët e Librit që nuk do ta besojë atë, përpara vdekjes së tij” dhe 2) “nuk do të ketë asnjë palë nga ithtarët e Librit që nuk do ta besojë atë, përpara vdekjes së tij” dhe pikërisht kjo e dyta është e saktë. Shumë hoxhallarë marrin variantin e parë për ta provuar se ngaqë ithtarët e Librit nuk e kanë besuar ende, ai nuk ka vdekur, gjë që së pari është një pretendim bosh, sepse miliona hebrenj kanë vdekur, të cilët as para vdekjes së tyre dhe as para “vdekjes” së Isait<sup>as</sup> nuk e kanë besuar atë. Së dyti, Kurani parashikon se mëria dhe grindja fetare mes judenjve e të krishterëve do të vijojnë deri në Ditën e Kiametit (5:15; 5:65), po kështu, parashikon se judenjtë deri në Ditën e Kiametit do të jenë të detyruar t’u nënshtrohen disa të krishterëve që e quajnë Jezusin<sup>as</sup> si të drejtë dhe të vërtetë (3:56). Nisur nga këto deklarata të Zotit, ky ajet nuk mund të ketë kuptimin që bëjnë hoxhallarët në fjalët për ta mbështetur idenë e tyre se Isai<sup>as</sup> është i gjallë dhe do të zbresë prej qiellit. Kuptimi i dytë që nënkupton “palën” është i saktë për arsye se *Hazret Mesihu*<sup>as</sup> ndërroi jetë pas mërgimit drejt fiseve të humbura izraelite, në një kohë kur e kishin besuar njerëzit nga secili fis dhe kjo ndodhi në Kashmir (lexoni 23:51).

163. Por prej tyre (pra, hebrenjve), të thelluarit në dije dhe besimtarët besojnë në atë që të është zbritur ty dhe në atë që është zbritur para teje, po ashtu, ata që falin namazin, paguajnë zekatin dhe besojnë Allahun dhe Ditën e Fundit. Këtyre do t'u japim një shpërblim madhor.

164. Sigurisht, Ne të kemi dërguar shpallje, ashtu siç i dërguam shpallje Nuhut dhe Profetëve pas tij. Gjithashtu, i dërguam shpallje Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit, pasardhësve (të tij), Isait, Ejubit, Junusit, Harunit dhe Sulejmanit. Dhe Daudit i dhamë Zeburin.

165. Ka të Dërguar që t'i kemi përmendur më parë dhe ka të Dërguar që nuk t'i kemi përmendur. Dhe Allahu ka folur shpesh me Musain.<sup>35</sup>

166. (Kemi sjellë) të Dërguar si sihariqdhënës dhe si alarmues, që njerëzit, pasi u erdhën të Dërguarit, të mos kenë argument kundër Allahut. Allahu është Mbizotërues, i Urtë.

لَكِنَّ الرُّسُوحُونَ فِي الْعِلْمِ مِنْهُمْ  
وَالْمُؤْمِنُونَ يُؤْمِنُونَ بِمَا أُنزِلَ إِلَيْكَ وَمَا  
أُنزِلَ مِنْ قَبْلِكَ وَالْمُقِيمِينَ الصَّلَاةَ  
وَالْمُؤْتُونَ الزَّكَاةَ وَالْمُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ  
وَالْيَوْمِ الْآخِرِ ۗ أُولَٰئِكَ سَنُؤْتِيهِمْ أَجْرًا  
عَظِيمًا ﴿٣٦﴾

إِنَّا أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ كَمَا أَوْحَيْنَا إِلَىٰ نُوحٍ  
وَالدَّيَّانِينَ مِنْ بَعْدِهِ ۗ وَأَوْحَيْنَا إِلَىٰ إِبْرَاهِيمَ  
وَإِسْمَاعِيلَ وَإِسْحَاقَ وَيَعْقُوبَ وَالْأَسْبَاطَ  
وَعِيسَىٰ وَيُوشَعَ وَيُونُسَ وَهَارُونَ  
وَسُلَيْمَانَ ۗ وَآتَيْنَا دَاوُدَ زَبُورًا ﴿٣٧﴾

وَ رُسُلًا قَدْ قَصَصْنَاهُمْ عَلَيْكَ مِنْ قَبْلُ  
وَ رُسُلًا لَمْ نَقْصُصْهُمْ عَلَيْكَ ۗ وَكَلَّمَ اللَّهُ  
مُوسَىٰ تَكْوِيمًا ﴿٣٨﴾

رُسُلًا مُبَشِّرِينَ وَ مُنذِرِينَ لِيَلَّا يَكُونَ  
لِلنَّاسِ عَلَى اللَّهِ حُجَّةٌ بَعْدَ الرُّسُلِ ۗ وَكَانَ  
اللَّهُ عَزِيزًا حَكِيمًا ﴿٣٩﴾

35. Sipas Kuranit, çdo popull ka pasur Profet (35:25), dhe sipas një hadithi, në botë kanë ardhur njëqind e njëzet e katër mijë Profetë (Musnedi i Ahmedit, nr. 22288), dhe, në pozitë, Profeti Muhammed<sup>savs</sup> qe më i larti prej tyre. Kurani i Shenjtë përmendi vetëm disa prej tyre si shembuj, duke na sjellë në pah ngjarjet më të spikatura të jetës së tyre dhe të popujve të tyre. Duket se të gjithë Profetët e tjerë kanë kaluar thujse nga të njëjtat rrethana dhe fenomene shoqërore, që kanë hasur Profetët që janë përmendur në Kuran. Dhe me ardhjen e tij, Profeti Muhammed<sup>savs</sup> i përmbledh të gjithë ata. Kurani i Shenjtë përmendi 25 Profetë gjithsej, duke përfshirë edhe Profetin Muhammed<sup>savs</sup>, siç ishte parashikuar në një profeci në librin “Zbulesa” (Bibla (Dhiata e Re), Zbulesa 4:10-11). Lexoni edhe 40:79.

167. Por, Allahu dëshmon se atë që të ka zbritur ty e ka zbritur me dijen e Tij (të prerë) dhe (këtë) e dëshmojnë edhe engjëjt. Allahu është i mjaftueshëm si Dëshmitar.

لَكِنَّ اللَّهَ يَشْهَدُ بِمَا أَنْزَلَ إِلَيْكَ أَنْزَلَهُ  
بِعِلْمِهِ ۗ وَالْمَلِكَةُ يَشْهَدُونَ ۗ وَكَفَى بِاللَّهِ  
شَهِيدًا ﴿١٦٧﴾

168. Pa dyshim, ata që mohuan dhe penguan në rrugën e Allahut, kanë përfunduar në humbje të thellë.

إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا وَصَدُّوا عَنْ سَبِيلِ اللَّهِ  
قَدْ ضَلُّوا ضَلًّا بَعِيدًا ﴿١٦٨﴾

169. Pa dyshim, ata që mohuan dhe bënë mizori, Allahu nuk ka për t'i falur dhe as nuk ka për t'u treguar ndonjë rrugë,

إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا وَظَلَمُوا لَمْ يَكُنِ اللَّهُ  
لِيَعْفِرْ لَهُمْ وَلَا لِيَهْدِيَهُمْ طَرِيقًا ﴿١٦٩﴾

170. përveç rrugës së xhehenemit, në të cilin ata do të mbesin gjatë. Dhe kjo është e lehtë për Allahun.

إِلَّا طَرِيقَ جَهَنَّمَ خُلِدِينَ فِيهَا أَبَدًا ۗ وَكَانَ  
ذَلِكَ عَلَى اللَّهِ يَسِيرًا ﴿١٧٠﴾

171. O njerëz! Juve ju ka ardhur i Dërguari me të vërtetën prej Zotit tuaj. Prandaj, besojeni, se është mirë për ju. Dhe nëse mohoni, e Allahut është gjithçka që është nëpër qiej e në tokë. Allahu është i Gjithëdijshëm, i Urtë.

يَا أَيُّهَا النَّاسُ قَدْ جَاءَكُمْ الرَّسُولُ بِالْحَقِّ مِنْ  
رَبِّكُمْ فَأَمِنُوا خَيْرًا لَكُمْ ۗ وَإِنْ تَكْفُرُوا  
فَإِنَّ لِلَّهِ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ۗ وَكَانَ  
اللَّهُ عَلِيمًا حَكِيمًا ﴿١٧١﴾

172. O ithtarët e Librit! Mos e kaloni kufirin në besimin tuaj dhe mos thoni për Allahun asgjë tjetër përveç së vërtetës! Mesihu, Isai biri i Merjemes, është vetëm i Dërguar i Allahut dhe fjala e Tij, të cilën Ai ia dërgoi Merjemes dhe është një Shpirt prej Tij. Andaj, besojeni Allahun dhe të Dërguarit e Tij dhe mos thoni "Tre!" Tërhiquni, se është mirë për ju! Sigurisht, Allahu është i Adhurueshmi i Vetëm. Ai është i pastër të ketë djalë. E Atij është çka

يَا أَهْلَ الْكِتَابِ لَا تَغْلُوا فِي دِينِكُمْ وَلَا  
تَقُولُوا عَلَى اللَّهِ إِلَّا الْحَقَّ ۗ إِنَّمَا الْمَسِيحُ  
عِيسَى ابْنُ مَرْيَمَ رَسُولُ اللَّهِ وَكَلَّمَتْهُ  
أَنْفُسًا إِلَى مَرْيَمَ وَرُوحٌ مِنْهُ فَآمِنُوا  
بِاللَّهِ وَرُسُلِهِ ۗ وَلَا تَقُولُوا ثَلَاثًا ۗ انْتَهَوْا  
خَيْرًا لَكُمْ ۗ إِنَّمَا اللَّهُ إِلَهٌ وَاحِدٌ ۗ سُبْحَانَ  
أَنْ يَكُونَ لَهُ وَكَلْدٌ لَهُ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا

gjendet në qiej dhe çka gjendet në tokë. Dhe Allahu është i mjaftueshëm si Rregullues.

173. Mesihut në asnjë mënyrë nuk i vjen keq të jetë rob i Allahut, po ashtu, as engjëjve të afërt. Ata që nuk e pëlqejnë adhurimin ndaj Tij dhe mburren, Ai do t'i mbledhë të gjithë para Vetes.

174. Atyre që besuan dhe bënë të mira, Ai do t'ua japë shpërblimet e tyre të plota dhe do t'u japë edhe më shumë nga bekimi i Tij. Kurse atyre që shpërfillën dhe u mburrën, do t'u japë ndëshkim të dhimbshëm. Ata nuk do të gjejnë dot për vete as mik e as ndihmës, përveç Allahut.

175. O njerëz! Juve ju ka ardhur një argument i qartë prej Zotit tuaj dhe ju kemi zbritur një dritë të qartë.

176. Ata që besuan Allahun dhe Atij iu përmbajtën fort, Ai me siguri do t'i pranojë në mëshirën dhe në bekimin e Tij dhe do t'i udhëzojë në rrugë të drejtë, drejt Vetes.

177. Ata të kërkojnë gjykim. Thuaju: Allahu ju jep gjykimin në lidhje me atë që nuk ka lënë as prindër e as fëmijë. Nëse vdes një burrë që nuk ka fëmijë, por ka motër, ajo do të marrë gjysmën e asaj që ka lënë ai. Kurse ai do ta trashëgojë (të gjithën), nëse ajo nuk ka lënë fëmijë. Dhe nëse (motrat) janë dy, ato do të kenë dy

فِي الْأَرْضِ ۖ وَكَفَى بِاللَّهِ وَكِيلًا ﴿٧٣﴾

لَنْ يَسْتَنْكِفَ الْمَسِيحُ أَنْ يَكُونَ عَبْدًا لِلَّهِ  
وَلَا الْمَلَائِكَةُ الْمُقَرَّبُونَ ۗ وَمَنْ يَسْتَنْكِفْ  
عَنْ عِبَادَتِهِ وَيَسْتَكْبِرْ فَسَيَحْشُرُهُمْ إِلَيْهِ  
جَمِيعًا ﴿٧٣﴾

فَأَمَّا الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ  
فَيُوَفِّيهِمْ أُجُورَهُمْ وَيَزِيدُهُمْ مِنْ فَضْلِهِ ۗ  
وَأَمَّا الَّذِينَ اسْتَنكَفُوا وَاسْتَكْبَرُوا  
فَيُعَذِّبُهُمْ عَذَابًا أَلِيمًا ۗ وَلَا يَجِدُونَ لَهُمْ  
مَنْ دُونِ اللَّهِ وَلِيًّا وَلَا نَصِيرًا ﴿٧٤﴾

يَأْتِيهَا النَّاسُ قَدْ جَاءَكُمُ بُرْهَانٌ مِّن  
رَّبِّكُمْ وَأَنْزَلْنَا إِلَيْكُمْ نُورًا مُبِينًا ﴿٧٥﴾

فَأَمَّا الَّذِينَ آمَنُوا بِاللَّهِ وَاعْتَصَمُوا بِهِ  
فَسَيُدْخِلُهُمْ فِي رَحْمَةٍ مِّنْهُ وَفَضْلٍ ۗ  
وَيَهْدِيهِمْ إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمًا ﴿٧٦﴾

يَسْتَفْتُونَكَ ۗ قُلِ اللَّهُ يَفْتِيكُمْ فِي الْكَلَالَةِ ۗ  
إِنْ امْرُؤًا هَلَكَ لَيْسَ لَهُ وَكْدٌ وَ لَهُ  
أُخْتٌ فَلَهَا نِصْفُ مَا تَرَكَ ۗ وَهُوَ يَرِثُهَا  
إِنْ لَمْ يَكُنْ لَهَا وَكْدٌ ۗ فَإِنْ كَانَتَا اثْنَتَيْنِ  
فَلَهُمَا الثُّلُثُ مِمَّا تَرَكَ ۗ وَإِنْ كَانُوا إِخْوَةً

të tretën e asaj që ka lënë ai. Dhe nëse do të jenë vëllezër e motra, pra, burra e gra, atëherë çdo mashkull do të ketë pjesën e dy femrave. Allahu ju shpjegon qartë, që të mos devijoni. Allahu është i Gjithëdijshtëm për çdo gjë.

رَجَالًا وَ نِسَاءً فَلِلَّذَكَرِ مِثْلُ حِظِّ  
 الْأُنثَيَيْنِ ۗ يُبَيِّنُ اللَّهُ لَكُمْ أَن تَصَلُّوا ۗ  
 ۚ وَاللَّهُ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ ﴿٣٧﴾



## Surja 5 – El-Maide

Surja El-Maide u zbrit në fund të periudhës medinase. Bashkë me *bismil-lahin*, ajo ka njëqind e njëzet e një ajete.

Kjo sure flet për realitetin e shumë prej mrekullive të *Hazret Isait*<sup>as</sup>. Shpesh komentuesit thonë se *Hazret Isait*<sup>as</sup> i ishte zbritur fizikisht një sofër prej qiellit, por kjo sure e bën të qartë se ajo ishte një profeci për popullin e krishterë që ata do të kenë ushqime e pasuri të bollshme, begati kjo që do t'u bëhej në saje të lutjeve dhe të sakrificave të *Hazret Isait*<sup>as</sup>, por me paralajmërimin se, nëse do të tregoheshin mosmirënjohës, shenja të së cilës, fatkeqësisht, kanë filluar të shfaqen, do të pësojnë ndëshkimin më të rëndë që nuk i është dhënë askujt më parë në botë.

Hebrenjtë dhe të krishterët, për shkak të shkeljes së besëlidhjes së tyre, u përfshinë në një sërë ligësish, dhe si duket, për këtë arsye, kjo sure që në krye të saj i jep paralajmërim *umetit* musliman që të mos ndjekin të njëjtën rrugë.

Më përpara, në suren El-Bekare, u përmend rreth ushqimeve të ndryshme të lejuara e të ndaluara, por në këtë sure u vu në dritë një aspekt i ri i kësaj teme, i cili e dallon Islamin nga të gjitha fetë e tjera. Sipas Islamit, ushqimi nuk mjafton vetëm të jetë hallall, por duhet të jetë edhe i pastër. Kështu që, një ushqim i caktuar edhe sikur të jetë hallall, besimtari, përpara se ta konsumojë atë, duhet të sigurohet që të jetë edhe i pastër dhe i shëndetshëm.

Para kësaj sureje, u përmend mësimi për të bërë drejtësi me qëndrueshmëri të plotë në çdo rrethanë. Në këtë sure, kjo temë rimerret në aspektin e dëshmimit, dhe besimtarët janë porositur të dëshmojnë me drejtësi aq të plotë dhe me qëndrueshmëri aq të palëkundur, saqë edhe armiqësia ndaj një populli nuk duhet t'i lejojë të bëjnë ndonjë padrejtësi ndaj tij dhe, gjatë gjykimeve të çështjeve të tyre me të, në asnjë mënyrë të mos e lënë drejtësinë.

Kjo sure edhe një herë përmend "*mithak-un*" (besëlidhjen) sesi hebrenjtë, për shkak të shkeljes së saj, ranë në armiqësi me njëri-tjetrin, aq sa u përçanë në 72 sekte. Kjo shkaktoi ardhjen e *Hazret Isait*<sup>as</sup>, i cili themeloi sektin e 73-të, pra grupin e shpëtuar. Megjithatë, në këtë sure, si profeci, thuhet se populli i *Isait*<sup>as</sup> nuk do të përfitojë nga këshilla dhe do të vijojë të përçahet në sekte të tjera dhe se edhe ata do t'i përfshijë ndasia, zilia dhe egoizmi, aq shumë saqë do të mbijnë midis tyre luftëra në shkallë botërore, në të cilat do të shikonim se popujt e krishterë do të luftonin keqas kundër popujve të tjerë po të krishterë.

Në këtë kontekst, ku flitet për luftëra të përgjakshme kundër njëri-tjetrit, flitet për një grup, i cili do të kalojë çdo kufi në mizori e barbari (ajeti 34), siç dëgjojmë sot që fëmijë të vegjël bëhen shënjestër të barbarisë së skajshme edhe në botën perëndimore, dhe shumë më dendur në botën lindore. Disa kryejnë akte makabre të paimagjinueshme, të cilat duhen dënuar ashpër që të zbatohet porosia "*edhe*

*pasardhësit e tyre të lëkunden*” (8:58), në mënyrë që kriminelët e tjerë të marrin mësim nga dënimi, përpara se të bëjnë ndonjë krim.

Kjo sure ngre zërin kundër çdolloj padrejtësie. Në këtë kontekst është thënë që në asnjë mënyrë nuk ju lejohet t’i ndërroni dikujt besimin me forcë. Nëse një numër njerëzish edhe sikur të largohen nga feja, duke mos duruar dhunën e skajshme, Allahu i Madhërishëm do t’i zëvendësojë ata me përforcime madhështore, të cilët jo vetëm që do të jenë më shumë në numër, por do të jenë shumë të dashur ndaj besimtarëve dhe shumë të fortë ndaj mohuesve.

Kjo sure sjell një mësim të ri të drejtësisë, i cili është i pashoq në llojin e vet dhe shembulli i tij nuk gjendet në asnjë Libër tjetër të botës. Ajeti në fjalë thotë se përveç besimtarëve të Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, edhe ithtarët e feve të tjera që u përmendën, do të shpërblehen për veprat e tyre të mira, në qoftë se u përmbahen mësimëve të vërteta të feve të tyre, dhe atyre do t’u thuhet: të mos shqetësohen e as të pikëllohen për fundin e tyre.

Duke treguar arsyet e ndasive dhe të përçarjeve, surja El-Maide rendit edhe alkoolin dhe bixhozin. Pavarësisht se ato mund të kenë disa dobi të vogla, dëmet e tyre pa dyshim janë shumë më të mëdha sesa dobitë e tyre.

Në mbyllje, kjo sure qartazi përmend vdekjen e *Hazret Isait*<sup>as</sup>, duke e paraqitur atë si një të Dërguar të përsosur që predikoi njëshmërinë e Zotit, kurse trininë ose *shirkun* asnjëherë. Ai asnjëherë nuk i predikoi popullit të vet që ta marrin atë dhe nënën e tij si zota pos Allahut.

1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. O ju që besuat! Plotësoni detyrimet! Ju lejohen kafshët, përveç asaj që do t'ju përmenden. Por, mos i lejoni vetes gjuetinë kur jeni në gjendje *ihrami*.<sup>1</sup> Allahu vendos atë që dëshiron.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا أَوْفُوا بِالْعُقُودِ ۗ أُحِلَّتْ لَكُمْ بَهِيمَةُ الْأَنْعَامِ إِلَّا مَا يُنْتَلَىٰ عَلَيْكُمْ ۗ غَيْرَ مُحِلِّي الصَّيْدِ وَأَنْتُمْ حُرْمٌ ۗ إِنَّ اللَّهَ يَحْكُمُ مَا يُرِيدُ ②

3. O ju që besuat! Mos çnderoni vendet e shenjta të Allahut, as muajin e shenjtë, as kurbanet, as kafshët e shënuara për kurban, as ata që janë nisur për Shtëpinë e shenjtë duke kërkuar bekim dhe pëlqim prej Zotit të tyre! Kur të lirohni nga *ihrami*, (mund të) bëni gjueti. Nuk duhet t'ju nxisë armiqësia ndaj një populli pse ai ju ka ndaluar nga Xhamia e shenjtë, që ju ta keqtrajtoni. Bashkëpunoni me njëri-tjetrin për mirësinë dhe druajtjen dhe mos bashkëpunoni për mëkatin dhe keqtrajtimin. Kini druajtje ndaj Allahut! Sigurisht, Allahu është i ashpër në ndëshkim.<sup>2</sup>

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَحِلُّوا شَعَائِرَ اللَّهِ وَلَا الشَّهْرَ الْحَرَامَ وَلَا الْهَدْيَ وَلَا الْقَلَائِدَ وَلَا آمِينَ الْبَيْتِ الْحَرَامِ يَبْتَغُونَ فَضْلًا مِّن رَّبِّهِمْ وَرِضْوَانًا ۗ وَإِذَا حَلَلْتُمْ فَاصْطَادُوا ۗ وَلَا يَجْرِمَنَّكُمْ شَنَاٰنُ قَوْمٍ أَن صَدَّوْكُمْ عَنِ الْمَسْجِدِ الْحَرَامِ أَن تَعْتَدُوا ۗ وَتَعَاوَنُوا عَلَى الْبِرِّ وَالتَّقْوَىٰ ۗ وَلَا تَعَاوَنُوا عَلَى الْإِثْمِ وَالْعُدْوَانِ ۗ وَاتَّقُوا اللَّهَ ۗ إِنَّ اللَّهَ شَدِيدُ الْعِقَابِ ③

4. Ju ndalohen ngordhësira, gjaku, mishi i derrit,<sup>3</sup> ajo që është therur a

حُرِّمَتْ عَلَيْكُمُ الْمَيْتَةُ وَالدَّمُ وَلَحْمُ الْخِنْزِيرِ وَمَا أَهَلَ لِغَيْرِ اللَّهِ بِهِ وَالْمُنْخَنِقَةُ

1. Në gjendje pelegrinazhi gjatë *haxhit* dhe *umrasë*.

2. Ajeti i 3-të dhe i 9-të i kësaj sureje porosisin për drejtësinë absolute edhe ndaj armikut, armiqësia me të cilin mund të jetë për shkaqe materiale apo fetare. Kështu, ajeti i 3-të thotë se nuk ju lejohet të bëni padrejtësi as ndaj atij armiku, që ju ka ndaluar të shkoni në Qabe. *Umeti* musliman, po t'i zbatonte këto dy ajete, kurrë nuk do të devijonte. Lexoni edhe 5:9.

3. Fjala arabe *khinzir* (derr) është e përbërë nga fjalët *khinz* dhe *ara*, që do të thotë: *unë atë*

blatuar në emër të dikujt tjetër pos Allahut, ajo që është e mbytur, e vrarë, e rrëzuar, e vrarë nga goditja e brinjëve, ajo që kanë ngrënë egërsirat, përveçse nëse e keni therur (përpara se të ngordhej), ajo që është e therur në altarin e të adhuruarve të rremë dhe, (ju ndalohet) gjithashtu, të ndani pjesët mes jush duke hedhur shigjetat e fatit. Këto janë ligësi. Sot kanë humbur shpresën mohuesit (të ndërhyjnë) në fenë tuaj. Andaj, mos u frikësoni prej tyre, por frikësohuni prej Meje. Sot kam përsosur fenë tuaj për ju dhe jua kam plotësuar bekimin Tim dhe kam pëlqyer Islamin për ju si fe. Kushdo që detyrohet nga uria e madhe (të hajë diçka të ndaluar), duke mos qenë i anuar nga mëkati, (le ta dijë se) Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

5. Ata të pyesin se çfarë u lejohet. Thuaju: Ju lejohen të pastrat. Ajo që ua mësoni kafshëve të gjuetisë, duke i stërvitur, është nga ajo që jua ka mësuar Allahu. Andaj, hani atë (prenë) që ato zënë për ju dhe përmendni emrin e Allahut mbi të. Kini druajtje ndaj Allahut! Sigurisht,

وَالْمَوْقُودَةَ وَالْمُتَرَدِّيَةَ وَالطَّيْحَةَ وَمَا  
 أَكَلَ السَّبْعُ إِلَّا مَا ذَكَّيْتُمْ وَمَا ذُبِحَ عَلَى  
 التُّصْبِ وَأَنْ تَسْتَقْسِمُوا بِالْأَزْلَامِ ذِكْرُكُمْ  
 فَسِقَ الْيَوْمِ يَيْسَ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ  
 دِينِكُمْ فَلَا تَخْشَوْهُمْ وَاخْشَوْنَ الْيَوْمَ  
 أَكْمَلْتُ لَكُمْ دِينَكُمْ وَأَتَمَمْتُ عَلَيْكُمْ  
 نِعْمَتِي وَرَضِيْتُ لَكُمُ الْإِسْلَامَ دِينًا  
 فَمَنِ اضْطُرَّ فِي مَخْمَصَةٍ غَيْرِ مُتَجَانِفٍ  
 لِإِثْمِهِ فَإِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَحِيمٌ ٥

يَسْأَلُونَكَ مَاذَا أُحِلَّ لَهُمْ قُلْ أُحِلَّ لَكُمْ  
 الطَّيْبُتُ وَمَا عَلَّمْتُمْ مِنَ الْجَوَارِحِ  
 مُكَلَّبِينَ تَعْلَمُونَهُنَّ مِمَّا عَلَّمَكُمُ اللَّهُ  
 فَكُلُوا مِمَّا أَمْسَكْنَ عَلَيْكُمْ وَاذْكُرُوا  
 اسْمَ اللَّهِ عَلَيْهِ وَاتَّقُوا اللَّهَ إِنَّ اللَّهَ

*e shoh të ndytë e të ligë. Khinz do të thotë e ndytë dhe ara do të thotë unë shoh. Nga kjo, del në pah edhe arsyeja e ndalimit të saj, sepse sipas ligjit të natyrës, mishi i një kafshe të tillë të paturpshme e të ndyrë në trupin dhe shpirtin e njeriut ndikon ndyrazi, sepse edhe ushqimet medoemos ndikojnë në shpirtin e njeriut. Prandaj, nuk ka dyshim që një e keqe e tillë, ka ndikim negativ. Nisur nga vetitë e kësaj kafshe, mund të pohojmë se mishi i saj ul ndjenjën e turpit dhe shfrenon epshet. Sheriati Islam e ndalon edhe mishin e kafshës së ngordhur, sepse edhe ai ndikon me natyrën e vet tek ai që e ha. Mishi i saj është edhe i dëmshëm për shëndetin. Kafshët që ngordhin dhe ndërkojnë gjaku u mbetet në trup, për shembull ajo që mbytet ose që ngordh nga rrahjet, të gjitha këto përfshihen në kategorinë e kafshëve të cofëta. Të gjitha këto janë të ndaluara jo vetëm për arsye shëndetësore, por edhe për arsye se ato ndikojnë edhe në shpirt. Sipas Islamit të gjitha lëvizjet e trupit të njeriut, ndikojnë edhe te shpirti i tij.*

Allahu është i shpejtë në llogari.

سَرِيعَ الْحِسَابِ ۝

6. Sot, juve ju janë bërë të lejueshme të pastrat. Gjithashtu, ju është bërë i lejueshëm ushqimi (i pastër) i atyre që u është dhënë Libri<sup>4</sup> dhe, edhe ushqimi juaj është i lejuar për ta. Po ashtu, të dëlirat besimtare dhe të dëlirat nga ata që u është dhënë Libri para jush, pasi ua jepni dhuratën e martesës duke qenë të dëlirë dhe jo të shthurur e as si ata që zënë dashnore.<sup>5</sup> Ai që e mohon besimin, vepra e tij ka rënë, dhe në *ahiret*, ai do të jetë mes të humburve.

أَلْيَوْمَ أُحِلَّ لَكُمْ الطَّيِّبَاتُ وَطَعَامُ  
الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ حَلَلٌ لَّكُمْ  
وَطَعَامُكُمْ حَلَلٌ لَهُمْ وَالْمُحْصَنَاتُ مِنَ  
الْمُؤْمِنَاتِ وَالْمُحْصَنَاتُ مِنَ الَّذِينَ أُوتُوا  
الْكِتَابَ مِنْ قَبْلِكُمْ إِذَا آتَيْتُمُوهُنَّ  
أُجُورَهُنَّ مُحْصِنِينَ غَيْرَ مُسْفِحِينَ  
وَلَا مُتَّخِذِي أَحْدَانٍ ۖ وَمَنْ يَكْفُرْ  
بِالْإِيمَانِ فَقَدْ حَبِطَ عَمَلُهُ ۖ وَهُوَ فِي  
بِئْسَ الْأَخِرَةِ مِنَ الْخَسِرِينَ ۝

7. O ju që besuat! Kur të ngriheni për namaz, pastroni fytyrat dhe duart tuaja deri në bërryla, fshini kokën me duar të lagur dhe lani edhe këmbët deri në nyje. Nëse jeni *xhunubë*, pastrohuni (duke u larë) tërësisht.<sup>6</sup> Nëse jeni të sëmurë ose jeni në udhë, ose dikush prej jush ka kryer nevojën fiziologjike ose keni kryer

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا قُمْتُمْ إِلَى الصَّلَاةِ  
فَاغْسِلُوا وُجُوهَكُمْ وَأَيْدِيَكُمْ إِلَى  
الْمَرَافِقِ وَامْسَحُوا بِرُءُوسِكُمْ وَأَرْجُلَكُمْ  
إِلَى الْكَعْبَيْنِ ۖ وَإِنْ كُنْتُمْ جُنُبًا  
فَاظْهَرُوا ۖ وَإِنْ كُنْتُمْ مَرْضَى أَوْ عَلَى  
سَفَرٍ أَوْ جَاءَ أَحَدٌ مِنْكُم مِّنَ الْغَايِطِ

4. Për sa u përket ushqimeve që konsumojnë të krishterët, ne besojmë se për ne janë të lejuara ato ushqime, që janë therur e gatuar në atë mënyrë, që përputhet edhe me mënyrën që paraqet Kurani. Përndryshe, do të rezultonte se disa ushqime të cilësuar si *haram*, që nuk i konsumon në shtëpinë tënde, t'i konsumoje në shtëpinë e dikujt tjetër, vetëm se ky i fundit është nga ithtarët e Librit. Mënyra siç është popullarizuar konsumi i mishit të derrit në vendet e të ashtuquajtura të krishtera, na detyron të kemi kujdes përpara se të konsumojmë ushqimet e tyre, po kështu edhe produktet e tyre ushqimore, sepse mundet që ato të kenë përbërës të ndryshëm të derrit. Përveç kësaj, Profeti<sup>savs</sup> na këshilloi që përpara se të konsumojmë mishin ose produktet e mishit që vijnë nga burime të tilla, edhe nëse ato nuk hyjnë në kategorinë e përmendur në ajetin 5:4, këshillohet të thuash “Bismil-lah” (me emrin e Allahut) dhe pastaj ta konsumosh (Buhari, nr. 5507). Sipas Ibni Abasit<sup>ra</sup>, fjala “ushqim i tyre” në këtë ajet nënkupton kafshën e therur nga ithtarët e Librit (Buhari, nr. 5508).

5. Lexoni 2:222.

6. Lexoni 4:44.

marrëdhënie me gratë tuaja, dhe (në këto raste) nuk gjeni dot ujë, bëni *tejemum* me dhe të pastër, pra, fshini fytyrat dhe duart tuaja me të. Allahu nuk dëshiron që të krijojë ndonjë vështirësi për ju, por dëshiron t'ju pastrojë dhe ta përsosë bekimin e Tij mbi ju, që ju ta falënderoni.

8. Kujtojeni bekimin e Allahut që keni mbi vete, si dhe besëlidhjen e Tij, që Ai ka lidhur fort me ju; kur thatë: “Dëgjuam dhe u bindëm” dhe kini druajtje ndaj Allahut! Sigurisht, Allahu është i Gjithëdijshtëm për gjithçka që mbajnë kraharorët.

9. O ju që besuat! Për hir të Allahut, bëhuni dëshmitarë të qëndrueshëm ndaj drejtësisë. Nuk duhet t'ju nxisë armiqësia e ndonjë populli, që ju të mos bëni drejtësi. Bëni drejtësi! Kjo është më afër druajtjes dhe kini druajtje ndaj Allahut! Sigurisht, Allahu është i Gjithinformuar ndaj asaj që bëni.<sup>7</sup>

10. Allahu u ka premtuar atyre që besuan dhe bënë të mira, që do të kenë falje dhe shpërblim madhor.

أَوَلَمْ سَتُمُ النِّسَاءَ فَلَمْ تَجِدُوا مَاءً فَتَيَمَّمُوا  
صَعِيدًا طَيِّبًا فَامْسَحُوا بِوُجُوْهِكُمْ  
وَأَيْدِيكُمْ مِنْهُ ۗ مَا يُرِيدُ اللَّهُ لِيَجْعَلَ  
عَلَيْكُمْ مِنْ حَرْجٍ ۗ وَلَكِنْ يُرِيدُ  
لِيُطَهِّرَكُمْ وَلِيُتِمَّ نِعْمَتَهُ عَلَيْكُمْ  
لَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ ﴿٧﴾

وَأذْكُرُوا نِعْمَةَ اللَّهِ عَلَيْكُمْ وَمِيثَاقَهُ  
الَّذِي وَآثَقْتُمْ بِهِ ۖ إِذْ قُلْتُمْ سَمِعْنَا  
وَأَطَعْنَا ۗ وَاتَّقُوا اللَّهَ ۗ إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ بِذَاتِ  
الصُّدُورِ ﴿٨﴾

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُونُوا قَوْمِينَ لِلَّهِ  
شُهَدَاءَ بِالْقِسْطِ ۗ وَلَا يَجْرِمَنَّكُمْ شَنَاٰنُ  
قَوْمٍ عَلَىٰ أَلَّا تَعْدِلُوا ۗ إِعْدِلُوا ۗ هُوَ  
أَقْرَبُ لِلتَّقْوَىٰ ۗ وَاتَّقُوا اللَّهَ ۗ إِنَّ اللَّهَ  
خَبِيرٌ بِمَا تَعْمَلُونَ ﴿٩﴾

وَعَدَ اللَّهُ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ  
لَهُمْ مَغْفِرَةٌ وَأَجْرٌ عَظِيمٌ ﴿١٠﴾

7. Është e lehtë të tregosh mirësjellje ndaj armikut, por është shumë e vështirë t'ia mbrosh të drejtën dhe të mos e lësh drejtësinë gjatë dëshimit ose gjykimit ndaj tij. Këtë mund ta bëjë vetëm një njeri i fortë. Ka shumë që përdorin gjuhë të ëmbël për armiqet ose për kundërshtarët e tyre, por kur vjen koha për t'u dhënë të drejtën, nuk ua japin. Madje, nganjëherë kështu ndodh edhe mes vëllezërve. Mund të respektojnë e të duan njëri-tjetrin, por kur vjen puna për pasurinë, ka syresh që bëjnë padrejtësi. Për këtë arsye, Zoti i Madhërishtëm në këtë ajet nuk e përmendi dashurinë apo paqen, por kriterin që vendos dashurinë dhe paqen. Paqen dhe dashurinë e vërtetë mund ta vendosë vetëm ai që nuk i bën padrejtësi as armikut të tij dhe edhe atij i jep të drejtën që i takon. Lexoni edhe 4:136.

11. Dhe ata që mohuan dhe i quajtën gënjeshtër ajetet Tona, janë banorë të xhehenemit.

12. O ju që besuat! Kujtojeni bekimin e Allahut që keni mbi vete, kur një popull kishte vendosur t'i zgjaste duart drejt jush (për t'ju dëmtuar), por Ai i pengoi ato. Kini druajtje ndaj Allahut. Allahut le t'i mbështeten besimtarët.

13. Pa dyshim, Allahu u mori besëlidhjen (edhe) bijve të Izraelit dhe prej tyre ngriti dymbëdhjetë prijës.<sup>8</sup> Allahu u tha: “Sigurisht, Unë jam me ju; nëse do të falni namazin, do të paguani zekatin, do t'i besoni të Dërguarit e Mi, do t'i ndihmoni ata dhe do t'i jepni hua të mirë Allahut, Unë patjetër do t'ju zhduk ligësitë dhe do t'ju çoj në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Ai që do të mohojë edhe pas kësaj, ka humbur nga rruga e drejtë”.

14. Pra, për shkak se ata e thyen besëlidhjen e tyre, Ne i mallkuam dhe ua bëmë zemrat gurë. Ata ndërrojnë fjalën nga vendi i saj dhe harruan një pjesë të asaj që u ishte mësuar. Ti përherë do të informohesh për ndonjë pabesi të tyre, me përjashtim të një pakice prej tyre. Andaj, toleroju dhe anashkaloju! Sigurisht, Allahu i do mirëbërësit.

وَالَّذِينَ كَفَرُوا وَكَذَّبُوا بِآيَاتِنَا أُولَٰئِكَ أَصْحَابُ الْجَحِيمِ ⑩

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اذْكُرُوا نِعْمَتَ اللَّهِ عَلَيْكُمْ إِذْ هُمْ قَوْمٌ أَنْ يَبْسُطُوا إِلَيْكُمْ أَيْدِيَهُمْ فَكَفَّ أَيْدِيَهُمْ عَنْكُمْ ۗ وَاتَّقُوا اللَّهَ ۗ وَعَلَى اللَّهِ فَلْيَتَوَكَّلِ الْمُؤْمِنُونَ ⑪

وَلَقَدْ أَخَذَ اللَّهُ مِيثَاقَ بَنِي إِسْرَائِيلَ ۖ وَبَعَثْنَا مِنْهُمُ اثْنَيْ عَشَرَ نَقِيبًا وَقَالَ اللَّهُ إِنِّي مَعَكُمْ ۗ لَئِنْ أَقَمْتُمُ الصَّلَاةَ وَآتَيْتُمُ الزَّكَاةَ وَآمَنْتُمْ بِرُسُلِي وَعَزَّرْتُمُوهُمْ وَأَقْرَضْتُمُ اللَّهَ قَرْضًا حَسَنًا لَأُكَفِّرَنَّ عَنْكُمْ سَيِّئَاتِكُمْ وَلَا أُدْخِلَنَّكُمْ جَهَنَّمَ تَجَرَّى مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ ۗ فَمَنْ كَفَرَ بَعْدَ ذَلِكَ مِنْكُمْ فَقَدْ ضَلَّ سَوَاءَ السَّبِيلِ ⑫

فَمَا نَفِضَهُمْ مِيثَاقَهُمْ لَعْنَهُمْ وَجَعَلْنَا قُلُوبَهُمْ قَاسِيَةً يُحَرِّفُونَ الْكَلِمَ عَنْ مَوَاضِعِهِ ۗ وَنَسُوا حَظًّا مِمَّا ذُكِّرُوا بِهِ ۗ وَلَا تَرَالِ تَطَّلِعُ عَلَى خَائِنَةٍ مِنْهُمْ إِلَّا قَلِيلًا ۗ مِنْهُمْ فَاعْفُ عَنْهُمْ وَاصْفَحْ ۗ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُحْسِنِينَ ⑬

8. *Dymbëdhjetë prijës* nënkuptojnë dymbëdhjetë Profetë izraelitë, që erdhën pas Hazret Musait<sup>as</sup>. Kurse sipas disa burimeve të tjera, ishin dymbëdhjetë “princa”, të caktuar nga Hazret Musai<sup>as</sup> (Bibla, Numrat, 1:5-16; 1:44).

15. Edhe prej atyre që thonë: “jemi të krishterë” kemi marrë besëlidhjen. Edhe ata harruan një pjesë të asaj që u ishte mësuar. Andaj, kemi vënë armiqësinë dhe urrejtjen mes tyre deri në Ditën e Kiametit.<sup>9</sup> Allahu së shpejti do t’ua tregojë atë që kanë bërë ata.

16. O ithtarët e Librit! Sigurisht, juve ju ka ardhur i Dërguari Ynë që ju tregon qartë shumë gjëra që ju i fshihnit nga Libri, dhe ju toleron për shumë të tjera. Sigurisht, juve ju ka ardhur prej Allahut një dritë dhe një Libër i qartë.

17. Me anë të tij, Allahu i udhëzon ata që ndjekin pëlqimin e Tij, drejt rrugëve të paqes, dhe me urdhrin e Tij, i nxjerr nga errësirat në dritë dhe i udhëzon në rrugë të drejtë.

18. Pa dyshim, mohuan ata që thanë: “Allahu është pikërisht Mesihu, i biri i Merjemes”. Thuaju: E kush mund të ketë fuqi përballë Allahut, nëse Ai vendos ta asgjësojë Mesihun, birin e Merjemes dhe nënën e tij dhe të gjithë të tjerët që gjenden në tokë? I Allahut është sundimi i qiejve dhe i tokës dhe i gjithçkaje që ekziston

وَمِنَ الَّذِينَ قَالُوا إِنَّا نَصْرَىٰ أَحَدَنَا  
مِيثَاقَهُمْ فَنَسُوا حَظًّا مِمَّا ذُكِّرُوا بِهِ  
فَاغْرَيْنَا بَيْنَهُمُ الْعَدَاوَةَ وَالْبَغْضَاءَ إِلَى  
يَوْمِ الْقِيَامَةِ ۗ وَسَوْفَ يُنَبِّئُهُمُ اللَّهُ بِمَا كَانُوا  
يَصْعُقُونَ ﴿١٥﴾

يَا أَهْلَ الْكِتَابِ قَدْ جَاءَكُمْ رَسُولُنَا يُبَيِّنُ  
لَكُمْ كَثِيرًا مِمَّا كُنْتُمْ تُخْفُونَ مِنَ الْكِتَابِ  
وَيَعْفُو عَنْ كَثِيرٍ ۗ قَدْ جَاءَكُمْ مِنَ اللَّهِ  
نُورٌ وَكِتَابٌ مُبِينٌ ﴿١٦﴾

يَهْدِي بِهِ اللَّهُ مَنِ اتَّبَعَ رِضْوَانَهُ سُبُلَ  
السَّلَامِ وَيُخْرِجُهُم مِّنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ  
بِإِذْنِهِ وَيَهْدِيهِمْ إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ ﴿١٧﴾

لَقَدْ كَفَرَ الَّذِينَ قَالُوا إِنَّ اللَّهَ هُوَ الْمَسِيحُ  
ابْنُ مَرْيَمَ ۗ قُلْ فَمَنْ يَمْلِكُ مِنَ اللَّهِ  
شَيْئًا إِنْ أَرَادَ أَنْ يُهْلِكَ الْمَسِيحُ ابْنُ  
مَرْيَمَ وَأُمَّهُ وَمَنْ فِي الْأَرْضِ جَمِيعًا ۗ  
وَاللَّهُ مُلْكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَا

9. Ky dhe 5:65, përveç të tjerash hedhin poshtë edhe besimin e atyre muslimanëve të cilët presin që një Imam Mehdi, si dhe *Hazret Isai* që ka kaluar para dy mijë vitesh, të vijnë e të ndërmarrin xhihadin me armë, dhe të shfarosin çdokënd që nuk e pranon Islam, duke mos i lënë as opsionin e *xhizjes*. Besimi i tillë bie ndesh jo vetëm me parimet e lirisë fetare (2:257) që paraqet Islami, por edhe me këto profeci të qarta, të cilat të paktën një gjë na pohojnë: hebrenjtë dhe të krishterët do të vijnë në ekzistencë deri në Ditën e Kiametit. Andaj, çdo musliman që dëgjon shpjegimet se do të vijë një Imam Mehdi gjakatar, duhet t’i refuzojë ato, pasi janë në kundërshtim me ajetet e Kuranit.



midis të dyjave. Ai krijon çfarë të dojë. Allahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë.

19. Hebrenjtë dhe të krishterët thanë: “Ne jemi bijtë e Allahut dhe të dashurit e Tij”. Thuaju: Përse atëherë Ai ju ndëshkon për mëkatet tuaja?! E vërteta është që ju jeni vetëm njerëz, prej atyre që Ai ka krijuar. Ai fal kë të dojë dhe ndëshkon kë të dojë. I Allahut është sundimi i qiejve dhe i tokës dhe i gjithçkaje që ekziston midis të dyjave dhe tek Ai është kthimi.

20. O ithtarët e Librit! Pas një shkëputjeje të gjatë të të Dërguarve, juve ju ka ardhur i Dërguari Ynë, (që) ju shpjegon qartas, që të mos thoni: “Nuk na erdhi as ndonjë sihariqdhënës e as ndonjë alarmues”. Kështu që, tashmë ju ka ardhur një sihariqdhënës dhe alarmues. Allahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë.

21. Dhe (kujtojeni) kur Musai i tha popullit të vet: “O populli im! Kujtojeni bekimin e Allahut që keni mbi vete, kur Ai caktoi Profetë mes jush, ju bëri mbretër dhe ju dha atë që nuk i dha askujt nëpër botë.

22. O populli im! Hyni në tokën e shenjtë, të cilën Allahu jua ka caktuar dhe mos u ktheni duke treguar shpinën, sepse atëherë do të ktheheni të humbur”.

بَيْنَهُمَا ط يَخْلُقُ مَا يَشَاءُ ط وَاللَّهُ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿١٩﴾

وَقَالَتِ الْيَهُودُ وَالنَّصَارَى نَحْنُ أَبْنَاءُ اللَّهِ وَأَحِبَّاؤُهُ قُلْ فَلِمَ يُعَذِّبُكُمْ بِذُنُوبِكُمْ ط بَلْ أَنْتُمْ بَشَرٌ مِّمَّنْ خَلَقَ ط يَغْفِرُ لِمَن يَشَاءُ وَيُعَذِّبُ مَن يَشَاءُ ط وَاللَّهُ مُلْكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا وَإِلَيْهِ الْمَصِيرُ ﴿٢٠﴾

يَا أَهْلَ الْكِتَابِ قَدْ جَاءَكُمْ رَسُولُنَا يُبَيِّنُ لَكُمْ عَلَى فَتْرَةٍ مِّنَ الرَّسُلِ أَنْ تَقُولُوا مَا جَاءَنَا مِن بَشِيرٍ وَلَا نَذِيرٍ فَقَدْ جَاءَكُمْ بَشِيرٌ وَ نَذِيرٌ وَاللَّهُ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿٢١﴾

وَإِذْ قَالَ مُوسَى لِقَوْمِهِ يُقَوْمِ ادْكُرُوا نِعْمَةَ اللَّهِ عَلَيْكُمْ إِذْ جَعَلَ فِيكُمْ أَنْبِيَاءَ وَجَعَلَكُمْ مُلُوكًا وَآتَاكُمْ مَا لَمْ يُؤْتِ أَحَدًا مِّنَ الْعَالَمِينَ ﴿٢٢﴾

يُقَوْمِ ادْخُلُوا الْأَرْضَ الْمُقَدَّسَةَ الَّتِي كَتَبَ اللَّهُ لَكُمْ وَلَا تَرْتَدُّوا عَلَى أَدْبَارِكُمْ فَتَنْقَلِبُوا خَاسِرِينَ ﴿٢٣﴾

23. Ata thanë: “O Musa! Atje përnjëmend ka një popull të ashpër dhe ne kurrsesi nuk do të hyjmë atje, derisa ata nuk do të dalin prej saj. Kur do të dalin ata prej saj, vetëm atëherë do të hyjmë ne”.

قَالُوا يَمُوسَى إِنَّ فِيهَا قَوْمًا جَبَّارِينَ ۝  
وَإِنَّا لَن نَّدْخُلَهَا حَتَّىٰ يَخْرُجُوا مِنْهَا ۝  
فَإِن يَخْرُجُوا مِنْهَا فَإِنَّا دَاخِلُونَ ۝

24. Ndër të frikësuarit (ndaj Zotit), dy burra, të cilët i kishte bekuar Allahu, thanë: “Mësyjini ata nga porta (kryesore). E kur të hyni (një herë) në të, pa dyshim, ju do të jeni triumfues. Dhe tek Allahu mbështetuni, nëse jeni besimtarë”.

قَالَ رَجُلَانِ مِنَ الَّذِينَ يَخَافُونَ أَنعَمَ  
اللَّهُ عَلَيْهِمَا ادْخُلُوا عَلَيْهِمُ الْبَابَ ۖ فَإِذَا  
دَخَلْتُمُوهُ فَإِنَّكُمْ عَلَيْهِمْ ۖ وَعَلَى اللَّهِ  
فَتَوَكَّلُوا ۖ إِنَّ كُنْتُمْ مَوْمِنِينَ ۝

25. Ata thanë: “O Musa! Ne kurrsesi nuk do të hyjmë në atë (qytet), për sa kohë që ata do të jenë atje. Pra, shko ti dhe Zoti yt dhe luftoni, kurse ne këtu do të rrimë.”<sup>10</sup>

قَالُوا يَمُوسَى إِنَّا لَن نَّدْخُلَهَا أَبَدًا  
مَّا دَامُوا فِيهَا فَآذِهِبْ أَنْتَ وَرَبُّكَ فَقَاتِلَا  
إِنَّا لَهُمَّا قَاعِدُونَ ۝

26. Ai tha: “O Zoti im! Unë kam fuqi vetëm mbi vetveten dhe mbi vëllain tim. Andaj, Ti bëje ndarjen midis nesh dhe popullit të pabindshëm.”

قَالَ رَبِّ إِنِّي لَا أَمْلِكُ إِلَّا نَفْسِي وَأَخِي  
فَافْرُقْ بَيْنَنَا وَبَيْنَ الْقَوْمِ الْفَاسِقِينَ ۝

27. (Zoti) tha: Ajo (tokë e shenjtë) u është bërë e ndaluar për dyzet vjet.

قَالَ فَإِنَّهَا مُحَرَّمَةٌ عَلَيْهِمْ أَرْبَعِينَ سَنَةً ۖ  
يَتِيهُونَ فِي الْأَرْضِ ۖ فَلَا تَأْسَ عَلَى الْقَوْمِ

10. Nëse studiojmë historinë e bijve të Izraelit, do të vëmë re se njëra prej arsyeve kryesore për të cilën ata e pranuan *Hazret Musain*<sup>as</sup> ishte që të çliroheshin nga skllavëria ndaj Faraonit. Kurse për sa u përket çështjeve shpirtërore dhe zbatimit të porosive të Zotit, ata shpesh u treguan të dobët dhe shkelës. I thoshin *Hazret Musait*<sup>as</sup> – Nuk të besojmë ty, o Musa, derisa nuk do ta shohim Zotin përballë (2:56); “shko ti dhe Zoti yt dhe luftoni, kurse ne këtu do të rrimë” (5:25); Sapo Musai<sup>as</sup> mungonte, ata e merrnin vëçin për Zot. E kundërshtonin Profetin e tyre me kokëfortësi. Kurse fuqia bekuese e Profetit Muhammed<sup>saws</sup> ishte aq e madhe sa që ata që po sipas Kuranit bënin jetë shtazarakë (25:45), u pastruan, u dëlirësuan dhe u bënë gati për t’u flijuar pors kurbanë në rrugën e Allahut. Një shembull i tillë nuk gjendet në asnjë popull tjetër të mëparshëm. Ditën e betejës së Bedrit, kur muslimanët nuk ishin të paralajmëruar siç duhet për një përballje fizike me mohuesit, *Hazret Mikdad bin Esvedi*<sup>ra</sup> i tha – O i Dërguari i Allahut! Ne nuk të themi siç bijtë e Izraelit i thanë *Hazret Musait*<sup>as</sup> “shko ti dhe Zoti yt dhe luftoni ...” por të themi na pri e ne do të jemi me ty! (Buhari, nr. 4609).

الْفٰسِقِيْنَ ۝۳۱

Ata do të bredhin të hutuar nëpër tokë. Andaj, ti mos u pikëllo për popullin e pabindshëm.<sup>11</sup>

28. Lexoju atyre me saktësi ngjarjen e dy bijve të Ademit: kur ata të dy sollën kurban, njërit prej tyre iu pranua dhe tjetrit nuk iu pranua. Ai tha: “Përnjëmend do të të vras!” Ai iu përgjigj: “Sigurisht, Allahu ua pranon sakrificën vetëm atyre që kanë drujtje (ndaj Tij).

29. Nëse ti ngre dorën tënde për të më vrarë, unë nuk do të ngre dorën time për të të vrarë ty. Unë i frikësohem Allahut, Zotit të botëve.

30. Unë dua që ti të kthehesh duke mbartur edhe mëkatin tim dhe mëkatin tënd, që të bëhesh nga banorët e zjarrit. Kështu do të jetë dënimi i mizorëve”.

31. Atëherë vetja e tij e nxiti për vrasjen e vëllait dhe ai e vrau dhe u bë ndër të humburit.

32. Më pas Allahu dërgoi një korb, që mihte në tokë që t'i tregojë atij se si ta mbulojë kufomën e vëllait të vet. Ai tha: “Vaj për mua! Nuk jam treguar as sa ky korb, që ta mbuloja kufomën e vëllait tim!” Atëherë ai u bë ndër të penduarit.

11. Kur izraelitët u treguan frikakakë, Zoti dekretoi që ata të vazhdonin të vërtiteshin nëpër shkretëtirë për 40 vjet, në mënyrë që jeta e shkretëtirës t'i forconte, qoftë moralisht, ashtu edhe fizikisht. Gjatë kësaj periudhe, brezi i vjetër do të zhdukej thuajse, kurse brezi i ri do të kalitej me ndjenjën e guximit për të dalë më i fortë se paraardhësi, në mënyrë që të arrinin ta pushtonin Tokën e Premtuar. Ky ajet gjithashtu tregon se për shkak të gabimeve të besimtarëve, mund të shtyhet përmbushja e premtimit të Zotit.

وَأْتَلُ عَلَيْهِمْ نَبَأَ ابْنَيْ آدَمَ بِالْحَقِّ ۖ إِذْ قَرَّبَا قُرْبَانًا فَتُقْبِلَ مِنْ أَحَدِهِمَا وَلَمْ يُتَقَبَّلْ مِنَ الْآخَرِ ۗ قَالَ لَأَقْتُلَنَّكَ ۗ قَالَ إِنَّمَا يَتَقَبَّلُ اللَّهُ مِنَ الْمُتَّقِينَ ۝

لَئِنْ بَسَطْتَ إِلَىٰ يَدِكَ لِتَقْتُلَنِي مَا أَنَا بِبَاسِطٍ يَدِي إِلَيْكَ لِأَقْتُلَنَّكَ ۚ إِنَّي أَخَافُ اللَّهَ رَبَّ الْعَالَمِينَ ۝

إِنِّي أُرِيدُ أَنْ تَبُوءَ بِإِثْمِي وَإِثْمِكَ فَتَكُونَ مِنْ أَصْحَابِ النَّارِ ۚ وَذَلِكَ جَزَاءُ الظَّالِمِينَ ۝

فَطَوَّعَتْ لَهُ نَفْسُهُ قَتْلَ أَخِيهِ فَقَتَلَهُ فَأَصْبَحَ مِنَ الْخٰسِرِينَ ۝

فَبَعَثَ اللَّهُ غُرَابًا يَبْحَثُ فِي الْأَرْضِ لِيُرِيَهُ كَيْفَ يُورِئِي سَوْءَ أَخِيهِ ۗ قَالَ يُوَيْلْتِي ۙ أَعَجَزْتُ أَنْ أَكُونَ مِثْلَ هَذَا الْغُرَابِ فَأُوَارِي سَوْءَ أَخِي ۚ فَأَصْبَحَ مِنَ

التَّٰمِيْمِيْنَ ۝

33. Për këtë arsye, kemi shkruar për bijtë e Izraelit që kushdo që vret një njeri që nuk ka vrarë ndokënd ose që nuk ka shkaktuar trazirë në tokë, është sikur të ketë vrarë gjithë njerëzimin, dhe kushdo që i jep jetë, është sikur t'i ketë dhënë jetë gjithë njerëzimit. Sigurisht, atyre u erdhën të Dërguarit Tanë me shenjat e qarta, megjithatë, shumica prej tyre i shkelin kufijtë në tokë.

34. Dënimi i atyre që luftojnë kundër Allahut e të Dërguarit të Tij dhe orvaten për të bërë trazirë në tokë është të vriten keqas, ose të kryqëzohen ose t'u priten duart dhe këmbët të anëve të ndryshme ose të dëbohen nga vendi. I tillë është poshtërimi i tyre në këtë botë, dhe në *ahiret* dhe ata kanë një ndëshkim të madh.<sup>12</sup>

35. Përveç atyre që pendohen përpara se ju t'i mposhtni ata. Dijeni se Allahu me siguri është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

36. O ju që besuat! Kini druajtje ndaj Allahut dhe kërkonj mjetin (për t'u afruar) drejt Tij dhe luftoni në rrugën e Tij, që të keni sukses.<sup>13</sup>

12. Islami nuk heziton të marrë masa ekstreme kur interesat e shtetit apo të shoqërisë në përgjithësi kërkojnë të çrrënjosin një të keqe të rrezikshme. Ky ajet flet për kriminelët që shkaktojnë trazira të mëdha ose luftë në një shtet, një krim që merr jetë njerëzish. Dënimi i përshkruar këtu është i ndarë në katër kategori, ku çdo formë e dënimit u përgjigjet rrethanave përkatëse. Duhet sqaruar se vetëm shteti ka tagër për t'ua përcaktuar dhe për t'ua dhënë dënimin fajtorëve dhe jo individit. Fjalët “të dëbohen nga vendi”, sipas Imam Ebu Hanifes<sup>ra</sup>, nënkuptojnë burgimin (Kurtubiu, nën ajetin 5:33).

13. Në fjalët “kërkonj mjetin (për t'u afruar) drejt Tij”, me mjetin nënkupton të Dërguarin

مِنْ أَجْلِ ذَلِكَ كَتَبْنَا عَلَىٰ بَنِي إِسْرَائِيلَ أَنَّهُ مَنْ قَتَلَ نَفْسًا بِغَيْرِ نَفْسٍ أَوْ فَسَادٍ فِي الْأَرْضِ فَكَأَنَّمَا قَتَلَ النَّاسَ جَمِيعًا ۖ وَمَنْ أَحْيَاهَا فَكَأَنَّمَا أَحْيَا النَّاسَ جَمِيعًا ۚ وَلَقَدْ جَاءَتْهُمْ رُسُلُنَا بِالْبَيِّنَاتِ ثُمَّ إِنَّ كَثِيرًا مِّنْهُمْ بَعَدَ ذَلِكَ فِي الْأَرْضِ لَمُسْرِفُونَ ﴿٣٣﴾

إِنَّمَا جَزَاءُ الَّذِينَ يُحَارِبُونَ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَيَسْعَوْنَ فِي الْأَرْضِ فَسَادًا أَنْ يُقَتَّلُوا أَوْ يُصَلَّبُوا أَوْ تُقَطَّعَ أَيْدِيهِمْ وَأَرْجُلُهُمْ مِنْ خَلْفٍ أَوْ يُنْفَخُوا مِنَ الْأَرْضِ ۗ ذَلِكَ لَهُمْ خِزْيٌ فِي الدُّنْيَا وَلَهُمْ فِي الْآخِرَةِ عَذَابٌ عَظِيمٌ ﴿٣٤﴾

إِلَّا الَّذِينَ تَابُوا مِنْ قَبْلِ أَنْ تَقْدِرُوا عَلَيْهِمْ ۚ فَاعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَّحِيمٌ ﴿٣٥﴾

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَابْتَغُوا إِلَيْهِ الْوَسِيلَةَ وَجَاهِدُوا فِي سَبِيلِهِ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ ﴿٣٦﴾

37. Pa dyshim, ata që mohuan, sikur të jetë e atyre gjithçka që gjendet në tokë, madje edhe një tjetër sa ajo, dhe atë ta japin si shpagim për të shpëtuar nga ndëshkimi i Ditës së Kiametit, nuk do të pranohet prej tyre. Ata do të kenë ndëshkim të dhimbshëm.

إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا لَوَ أَنَّ لَهُمْ مَا فِي الْأَرْضِ  
جَمِيعًا وَمِثْلَهُ مَعَهُ لَيَفْتَدُوا بِهِ مِنْ عَذَابِ  
يَوْمِ الْقِيَامَةِ مَا تُقْبَلُ مِنْهُمْ ۚ وَلَهُمْ عَذَابٌ  
أَلِيمٌ ﴿٣٧﴾

38. Ata do të dëshirojnë të dalin nga zjarri, por nuk mund të dalin prej tij dhe ata do të kenë ndëshkim të qëndrueshëm.

يُرِيدُونَ أَنْ يُخْرِجُوا مِنَ النَّارِ وَمَا هُمْ  
بِخَارِجِينَ مِنْهَا ۚ وَلَهُمْ عَذَابٌ مُّقِيمٌ ﴿٣٨﴾

39. Vjedhësi dhe vjedhësja: preuani duart atyre, si dënim i asaj që ata kanë punuar dhe si ndëshkim nga Allahu. Allahu është Mbizotërues, i Urtë.<sup>14</sup>

وَالسَّارِقُ وَالسَّارِقَةُ فَاقْطَعُوا أَيْدِيَهُمَا  
جَزَاءً بِمَا كَسَبَا نَكَالًا مِنَ اللَّهِ ۗ وَاللَّهُ  
عَزِيزٌ حَكِيمٌ ﴿٣٩﴾

40. Dhe ai që pendohet pas mizorisë së vet dhe e përmirëson veten, Allahu do ta mëshirojë duke ia pranuar pendimin. Sigurisht, Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

فَمَنْ تَابَ مِنْ بَعْدِ ضَلَامِهِ وَاصْلَحَ فَإِنَّ  
اللَّهَ يَتُوبُ عَلَيْهِ ۗ إِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَحِيمٌ ﴿٤٠﴾

41. A nuk e di ti që sundimi i qiejve dhe i tokës është vetëm i Allahut?! Ai ndëshkon kë të dojë dhe fal kë të dojë dhe Allahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë.

أَلَمْ تَعْلَمْ أَنَّ اللَّهَ لَهُ مُلْكُ السَّمَوَاتِ  
وَالْأَرْضِ ۗ يُعَذِّبُ مَنْ يَشَاءُ وَيَغْفِرُ لِمَنْ  
يَشَاءُ ۗ وَاللَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿٤١﴾

e Allahut<sup>savs</sup>. Pra, kjo do të thotë se tani e tutje, përmes të Dërguarit të Allahut<sup>savs</sup>, pra duke e ndjekur atë, mund të krijosh lidhje me Zotin e Madhërishtëm. Edhe lutja pas ezanit, që përmend mjetin, e mbështet këtë ide.

14. Në këtë ajet, vjedhësi dhe vjedhësja nënkuptojnë ata burra e gra që e kanë ves vjedhjen dhe, kjo porosi, nuk përfshin vjedhje të zakonshme të ushqimeve të ndryshme që një nevojtar i varfër bën për shkak të urisë dhe të nevojave të tij. Nëse Kurani ka lënë tolerancë që njerëzit, kur janë skajshmërisht të uritur, mund të hanë edhe mishin e derrit, kuptohet që nëse një i uritur do të hajë ndonjë ushqim pa leje, nuk merret ndaj tij masat e tilla ekstreme.

42. O i dërguar! Të mos brengosin ty ata që përparojnë në mohim, të cilët me gojët e tyre thanë “ne besuam”, por zemrat e tyre nuk kanë besuar, si dhe ata që janë hebrenj. Ata e dëgjojnë me vëmendje gënjeshtren (dhe) dëgjojnë me vëmendje një popull tjetër, që akoma nuk erdhi te ti. Ata ndërrojnë fjalët nga vendet e tyre të duhura. Thonë: “Nëse ju jepet kjo merreni dhe nëse nuk ju jepet ajo, ruhuni!” Atë që Allahu dëshiron ta vërë në sprovë, nuk do të kesh aspak fuqi për ta shpëtuar nga Allahu. Këta janë njerëzit që Allahu nuk do që t’ua pastrojë zemrat. Ata kanë poshtërim në këtë botë dhe, në *ahiret*, do të kenë ndëshkim të madh.

43. E dëgjojnë gënjeshtren me shumë vëmendje dhe e gllabërojnë babëzisht paranë e ndaluar. Nëse do të vijnë te ti, gjykoji ose shmangu prej tyre. Nëse do t’u shmangesh, ata nuk mund të të dëmtojnë aspak dhe, nëse do t’i gjykos, gjykoji me drejtësi. Sigurisht, Allahu i do ata që bëjnë drejtësi.

44. E si mund të të marrin ty si gjykatës, ndërkohë që ata e kanë Teuratin, në të cilin gjendet urdhri i Allahut?! Prapëseprapë, ata e kthejnë shpinën. Ata kurrë nuk mund të bëhen besimtarë.

45. Pa dyshim, Ne e kemi zbritur Teuratin, në të cilin kishte udhëzim dhe dritë. Profetët që i ishin

يَا أَيُّهَا الرَّسُولُ لَا يَحْزُنْكَ الَّذِينَ يُسَارِعُونَ  
 فِي الْكُفْرِ مِنَ الَّذِينَ قَالُوا آمَنَّا بِأَفْوَاهِهِمْ  
 وَلَمْ تُؤْمِنْ قُلُوبُهُمْ ۗ وَمِنَ الَّذِينَ هَادُوا ۗ  
 سَمِعُونَ لِلْكَذِبِ سَمْعُونَ لِقَوْمٍ  
 آخَرِينَ ۗ لَمْ يَأْتُوكَ ۗ يَحْرِفُونَ الْكَلِمَةَ مِنْ  
 بَعْدِ مَوَاضِعِهِ ۗ يَقُولُونَ إِنْ أُوتِينَا هَذَا  
 فَخُدُّوه ۗ وَإِنْ لَمْ تُؤْتُوهُ فَاحْذَرُوا ۗ وَمَنْ  
 يُرِدِ اللَّهُ فِتْنَتَهُ فَلَنْ تَمْلِكَ لَهُ مِنَ اللَّهِ  
 شَيْئًا ۗ أُولَٰئِكَ الَّذِينَ لَمْ يُرِدِ اللَّهُ أَنْ  
 يُطَهِّرَ قُلُوبَهُمْ ۗ لَهُمْ فِي الدُّنْيَا خِزْيٌ ۗ وَ  
 لَهُمْ فِي الْآخِرَةِ عَذَابٌ عَظِيمٌ ﴿٥٢﴾

سَمِعُونَ لِلْكَذِبِ أَكَلُونَ لِلسُّحْتِ ۗ فَإِنْ  
 جَاءُوكَ فَاحْكُم بَيْنَهُمْ أَوْ أَعْرِضْ  
 عَنْهُمْ ۗ وَإِنْ تُعْرِضْ عَنْهُمْ فَلَنْ  
 يَضُرُّوكَ شَيْئًا ۗ وَإِنْ حَكَمْتَ فَاحْكُم  
 بَيْنَهُمْ بِالْقِسْطِ ۗ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُقْسِطِينَ ﴿٥٣﴾

وَكَيْفَ يُحْكِمُوكَ وَعِنْدَهُمُ التَّوْرَةُ فِيهَا  
 حُكْمُ اللَّهِ ثُمَّ يَتَوَلَّوْنَ مِنْ بَعْدِ ذَلِكَ ۗ وَمَا  
 نَجْعُ أُولَٰئِكَ بِالْمُؤْمِنِينَ ﴿٥٤﴾

إِنَّا أَنْزَلْنَا التَّوْرَةَ فِيهَا هُدًى وَ نُورٌ  
 يُحْكُمُ بِهَا النَّبِيُّونَ الَّذِينَ أَسْلَمُوا لِلَّذِينَ

nënshtuar (tërësisht Allahut) i gjykonin hebrenjtë me anë të tij. Po ashtu, (gjykonin) edhe njerëzit e Zotit dhe dijetarët, për arsye se atyre u ishte besuar mbrojtja e Librit të Allahut dhe ata ishin dëshmitarë për këtë. Prandaj, mos u frikësoni nga njerëzit dhe frikësohuni prej Meje dhe mos i këmbeni ajetet e Mia me çmim të ulët. Pikërisht ata që nuk gjykojnë sipas asaj që Allahu ka zbritur, janë mohues.

46. Ne u kishim bërë të obligueshme në të (pra, në Teurat): jetën për jetë, syrin për sy, hundën për hundë, veshin për vesh dhe dhëmbin për dhëmb dhe ka hakmarrje të barabartë edhe për plagët.<sup>15</sup> Ai që e fal vetë, kjo për të do të jetë shlyerje (e mëkateve të tij). Dhe ata që nuk gjykojnë sipas asaj që Allahu ka zbritur, janë keqbërës.

47. Në gjurmët e tyre e dërguam edhe Isain birin e Merjemes, si vërtetues të asaj që ai kishte përpara nga Teurati, dhe atij i kemi dhënë Inxhilin, në të cilin kishte udhëzim dhe dritë. Edhe (Inxhili) ishte vërtetues i asaj që ai kishte përpara nga Teurati. Për të druajturit, ai ishte një udhëzim dhe këshillë.

48. Le të gjykojnë ithtarët e Inxhilit sipas asaj që Allahu ka zbritur në të. Dhe ata që nuk gjykojnë sipas asaj që Allahu ka zbritur, janë të

هَادُوا وَالرَّبِّيُّونَ وَالْأَخْبَارُ بِمَا اسْتَحْفَظُوا  
مِنْ كِتَابِ اللَّهِ وَكَانُوا عَلَيْهِ شُهَدَاءَ ۖ فَلَا  
تَخْشَوُا النَّاسَ وَاحْشَوْنَ وَلَا تَسْتُرُوا  
بِأَيْبَىٰ نَمًّا قَلِيلًا ۗ وَمَنْ لَّمْ يَحْكَمْ بِمَا  
أَنْزَلَ اللَّهُ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْكٰفِرُونَ ﴿٤٦﴾

وَكَتَبْنَا عَلَيْهِمْ فِيهَا أَنَّ النَّفْسَ بِالنَّفْسِ  
وَالْعَيْنَ بِالْعَيْنِ وَالْأَنْفَ بِالْأَنْفِ وَالْأُذْنَ  
بِالْأُذُنِ وَالسِّنَّ بِالسِّنِّ وَالْجُرُوحَ  
قِصَاصًا ۗ فَمَنْ تَصَدَّقَ بِهِ فَهُوَ كَفَّارَةٌ لَّهُ ۗ  
وَمَنْ لَّمْ يَحْكَمْ بِمَا أَنْزَلَ اللَّهُ فَأُولَٰئِكَ  
هُمُ الظَّالِمُونَ ﴿٤٧﴾

وَقَفَّيْنَا عَلَىٰ آثَارِهِم بِعِيسَى ابْنِ مَرْيَمَ  
مُصَدِّقًا لِّمَا بَيْنَ يَدَيْهِ مِنَ التَّوْرَةِ  
وَآتَيْنَاهُ الْإِنجِيلَ فِيهِ هُدًى وَنُورٌ  
وَ مُصَدِّقًا لِّمَا بَيْنَ يَدَيْهِ مِنَ التَّوْرَةِ  
وَهُدًى وَ مَوْعِظَةً لِّلْمُتَّقِينَ ﴿٤٨﴾

وَلِيَحْكَمْ أَهْلَ الْإِنجِيلِ بِمَا أَنْزَلَ اللَّهُ  
فِيهِ ۗ وَمَنْ لَّمْ يَحْكَمْ بِمَا أَنْزَلَ اللَّهُ

15. Lexoni: Bibla, Eksodi 21:23-25; Levitiku 24:19-21.

pabindshëm.<sup>16</sup>

49. Dhe Ne ty të kemi zbritur Librin me vërtetësi, si vërtetues të asaj që ka përpara nga Libri dhe si mbikëqyrës të saj. Andaj, gjyko mes tyre sipas asaj që Allahu ka zbritur dhe mos ndiq dëshirat e tyre, duke lënë të vërtetën që të ka ardhur. Për të gjithë ju kemi lënë një ligj dhe një rrugë. Sikur të donte Allahu, do t'ju bënte një popull të vetëm, por Ai do t'ju sprovtojë me anë të asaj që jua ka dhënë. Prandaj, garoni në mirësi! Tek Allahu do të ktheheni ju të gjithë. Më pas, Ai do t'ju tregojë të vërtetën e asaj, rreth së cilës kundërshtonit njëri-tjetrin.

50. Dhe gjyko mes tyre sipas asaj që Allahu ka zbritur dhe mos ndiq dëshirat e tyre dhe ruhu prej tyre që të të mos vënë në sprovë për ndonjë pjesë të atij (mësimi) që Allahu të ka zbritur. Nëse ata do ta kthejnë shpinën, dije se Allahu dëshiron t'i vërë në vështirësi për shkak të disa mëkateve të tyre. Dhe shumica prej njerëzve janë të padëgjueshëm.

51. A dëshirojnë ata gjykimin e injorancës?!<sup>17</sup> Për ata që besojnë me bindje, kush mund të jetë më i mirë në gjykim sesa Allahu?!

فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْفٰسِقُونَ ﴿٤٩﴾

وَأَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ مُصَدِّقًا لِّمَا بَيْنَ يَدَيْهِ مِنَ الْكِتَابِ وَمُهَيِّمًا عَلَيْهِ فَاحْكُم بَيْنَهُم بِمَا أَنْزَلَ اللَّهُ وَلَا تَتَّبِعْ أَهْوَاءَهُمْ عَمَّا جَاءَكَ مِنَ الْحَقِّ لِكُلِّ جَعَلْنَا مِنْكُمْ شُرْعَةً وَ مِنْهَا جَا ١٠ وَ لَوْ شَاءَ اللَّهُ لَجَعَلَكُمْ أُمَّةً وَاحِدَةً وَ لٰكِنْ لِّيَبْلُوَكُمْ فِي مَا آتٰكُمْ فَاسْتَبِقُوا الْخَيْرَاتِ ١١ إِلَى اللَّهِ مَرْجِعُكُمْ جَمِيعًا فَيُنَبِّئُكُمْ بِمَا كُنْتُمْ فِيهِ تَخٰلِفُونَ ﴿٥٠﴾

وَإِنِ احْكُم بَيْنَهُم بِمَا أَنْزَلَ اللَّهُ وَلَا تَتَّبِعْ أَهْوَاءَهُمْ وَاحِدَهُمْ أَنْ يَفْتُتُوا عَنْ بَعْضِ مَا أَنْزَلَ اللَّهُ إِلَيْكَ فَإِن تَوَلَّوْا فَاعْلَمُوا أَنَّمَا يُرِيدُ اللَّهُ أَنْ يُصِيبَهُمْ بِبَعْضِ ذُنُوبِهِمْ ١٢ وَإِن كَثِيرًا مِّنَ النَّاسِ لَفٰسِقُونَ ﴿٥١﴾

أَفَحُكْمَ الْجَاهِلِيَّةِ يَبْغُونَ ١٣ وَمَنْ أَحْسَنُ بَعْدَ ذَلِكَ مِنْ اللَّهِ حُكْمًا لِّقَوْمٍ يُؤْفِكُونَ ﴿٥٢﴾

16. Teurati dhe Ungjilli përmbajnë profeci për ardhjen e Profetit Muhammed<sup>savs</sup> (lexoni te 7:158). Ky ajet u drejtohet ithtarëve të Librit duke thënë – nëse nuk gjykoni sipas asaj që Zoti ju ka shpallur juve, do të jeni shkelës.

17. Gjykimi i injorancës nënkupton sjelljen para islame.



52. O ju që besuat! Mos i bëni shokë hebrejntë dhe të krishterët! Ata janë shokë të njëri-tjetrit. Ai që i bën shokë, do të jetë prej tyre. Sigurisht, Allahu nuk e udhëzon popullin e padrejtë.<sup>18</sup>

53. Ata që kanë sëmundje në zemër, do t'i shohësh që mes tyre vërtiten. Thonë: “Kemi frikë se mos na godet ndonjë fatkeqësi”. Kështu që, mundet që Allahu të sjellë fitoren ose ndonjë vendim të Tij, dhe ata të bëhen të penduar për të, për shkak të asaj që e fshehin në veten e tyre.

54. Dhe ata që besuan, thonë: “Vallë, a ishin këta që bënë be e rrufe për Allahun, që ata medoemos janë me ju?!” Këtyre iu prishën veprat dhe kështu, ata u bënë të humbur.

55. O ju që besuat! Kushdo prej jush që kthehet nga besimi i tij, (në këmbim të tij) Allahu do të sjellë një popull që Ai i do dhe ata do ta duan Atë; ata do të jenë të dhembshur ndaj besimtarëve, të fortë ndaj mohuesve. Ata do të luftojnë në rrugën e Allahut dhe nuk do të frikësohen nga qortimi i asnjë qortuesi. Ky është

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَتَّخِذُوا الْيَهُودَ  
وَالنَّصَارَىٰ أَوْلِيَاءَ بَعْضُهُمْ أَوْلِيَاءُ بَعْضٍ  
وَمَنْ يَتَوَلَّهُمْ مِنْكُمْ فَاِنَّهُ مِنْهُمْ ۗ إِنَّ  
اللَّهَ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الظَّالِمِينَ ﴿٥٢﴾

فَتَرَى الَّذِينَ فِي قُلُوبِهِمْ مَرَضٌ يُسَارِعُونَ  
فِيهِمْ يَقُولُونَ نَخْشَىٰ أَنْ تُصِيبَنَا دَائِرَةٌ ۗ  
فَعَسَىٰ اللَّهُ أَنْ يَأْتِيَ بِالْفَتْحِ أَوْ أَمْرٍ مِّنْ  
عِنْدِهِ فَيُصْبِحُوا عَلَىٰ مَا أَسْرَوْا فِي  
أَنفُسِهِمْ لُدْمِينَ ﴿٥٣﴾

وَيَقُولُ الَّذِينَ آمَنُوا أَهَؤُلَاءِ الَّذِينَ  
أَقْسَمُوا بِاللَّهِ جَهْدَ أَيْمَانِهِمْ ۗ إِنَّهُمْ  
لَمَعَكُمْ ۗ حَبِطَتْ أَعْمَالُهُمْ فَأَصْبَحُوا  
خُسْرَيْنِ ﴿٥٤﴾

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا مَنْ يَرْتَدَّ مِنْكُمْ عَنْ  
دِينِهِ فَسَوْفَ يَأْتِي اللَّهُ بِقَوْمٍ يُحِبُّهُمْ  
وَيُحِبُّونَهُ ۗ أَذِلَّةٍ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ أَعِزَّةٍ عَلَى  
الْكَافِرِينَ ۗ يُجَاهِدُونَ فِي سَبِيلِ اللَّهِ وَلَا  
يَخَافُونَ لَوْمَةَ لَائِمٍ ۗ ذَلِكَ فَضْلُ اللَّهِ

18. Dashuria deri në shkallën që të pajtohesh me jomuslimanin në bindjet dhe veprimet e tij fetare, nuk lejohet për muslimanin. Po, muslimani duhet të ketë dhembshuri të sinqertë ndaj jomuslimanit, të kujdeset me gjithë zemër për problemet e tij shëndetësore, shoqërore dhe shpirtërore, sepse Zoti në Kuran vazhdimisht na mëson se duhet t'i përngajmë Gjithëmëshirës së Tij, pra, pa dallim feje, race, ngjyre, kombi a gjuhe, të kemi dhembshuri ndaj të gjithë njerëzve, të ushqejmë të uriturit, t'u lehtësojmë borxhlinjve barrën e borxhit, të lirojmë ata që janë në skllavëri e të ndihmojmë çdokënd ne nevojë. Lexoni edhe 60:9-10.

bekim i Allahut që Ai ia jep kujt të dojë. Dhe Allahu është Zgjerues, i Gjithëdijshëm.<sup>19</sup>

56. Miqtë tuaj, në të vërtetë, janë Allahu, i Dërguari i Tij dhe ata që besuan, që falin namazin, japin zekatin dhe që janë të përkulur (para Allahut).

57. Ai që bën mik Allahun, të Dërguarin e Tij si dhe ata që besuan, (ta dijë se) vetëm grupi i Allahut do të triumfojë.

58. O ju që besuat! Nga njerëzit që u është dhënë Libri para jush, mos i bëni miq ata që tallen dhe luajnë me fenë tuaj dhe as mohuesit! Kini druajtje ndaj Allahut, nëse jeni besimtarë!<sup>20</sup>

59. E kur ju thërrisni për namaz, ata e marrin për tallje dhe për lojë. Kështu bëjnë, sepse janë popull që nuk kuptojnë.

60. Thuaju: O ithtarët e Librit! A na qortoni ne vetëm sepse kemi besuar Allahun, atë që na është zbritur neve dhe atë që është zbritur më përpara?! E vërteta është që shumica prej jush janë të pabindshëm.

يُؤْتِيهِ مَنْ يَشَاءُ وَاللَّهُ وَاسِعٌ عَلِيمٌ ﴿٥٦﴾

إِنَّمَا وَلِيُّكُمُ اللَّهُ وَرَسُولُهُ وَالَّذِينَ آمَنُوا  
الَّذِينَ يُتِمُّونَ الصَّلَاةَ وَيُؤْتُونَ الزَّكَاةَ  
وَهُمْ رَاكِعُونَ ﴿٥٧﴾

وَمَنْ يَتَوَلَّ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَالَّذِينَ آمَنُوا  
فَإِنَّ حِزْبَ اللَّهِ هُمُ الْغَالِبُونَ ﴿٥٨﴾

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَتَّخِذُوا الَّذِينَ  
اتَّخَذُوا دِينَكُمْ هُرُورًا وَ لَعِبًا مِنَ الَّذِينَ  
أُوتُوا الْكِتَابَ مِنْ قَبْلِكُمْ وَالْكَافِرَ أَوْلِيَاءَ  
وَاتَّقُوا اللَّهَ إِنَّ كُنتُمْ مُؤْمِنِينَ ﴿٥٩﴾

وَإِذَا نَادَيْتُمْ إِلَى الصَّلَاةِ اتَّخَذُوا هُرُورًا  
وَلَعِبًا ذَلِكَ بِأَنَّهُمْ قَوْمٌ لَا يَعْقِلُونَ ﴿٦٠﴾

قُلْ يَا أَهْلَ الْكِتَابِ هَلْ تَتَّقُمُونَ مِنَّا إِلَّا  
أَنْ أَمَّا بِاللَّهِ وَمَا أُنزِلَ إِلَيْنَا وَمَا أُنزِلَ  
مِنْ قَبْلُ وَإِنَّ أَكْثَرَكُمْ فُسِّقُونَ ﴿٦٠﴾

19. Ky ajet hedh poshtë mendimin se apostati (ai që heq dorë nga besimi) të dënohet me vdekje, sepse thotë: nëse ndokush prej jush bëhet renegat, Zoti do ta zëvendësojë atë me një popull, të cilët do t'i duan besimtarët dhe do të jenë të fortë ndaj mohuesve.

20. Lexoni 5:52 dhe 60:9-10.

61. Thuaju: A t'ju njoftoj për një gjë që është akoma më e keqe sesa kjo si dënim (për ju) tek Allahu? Është ai që e mallkoi Allahu, të cilit iu zemërua dhe disa prej tyre i bëri majmunë dhe derra, kur ata e adhuruan djallin. Pikërisht këta janë më të këqij për nga pozita dhe më të devijuar prej rrugës së drejtë.<sup>21</sup>

62. Dhe kur vijnë tek ju, thonë: “Besuam”, ndërkohë që me mohim ata hynë (te ju) dhe po me të dolën. Allahu e di më së miri atë që ata fshehin.

63. Shumicën prej tyre do t'i shohësh duke garuar në mëkate, keqbërje dhe në gllabërimin e pasurisë së palejueshme. Sa keq punojnë ata!

64. Ata (që quhen) të Zotit dhe ata që janë dijetarë pse nuk i ndaluan të flisnin për mëkate dhe të hanin pasurinë e palejueshme?! Sa keq bëjnë ata!

65. Hebrenjtë thanë: “Dora e Allahut është e shtrënguar”. Atyre iu shtrënguan duart dhe ata u mallkuan për shkak të asaj që thanë. Përkundrazi, duart e Tij janë të gjera. Ai i përdor si të dojë. Ajo që të është zbritur ty prej Zotit tënd, do t'i shtojë shumicës prej tyre vetëm rebelimin dhe mohimin. Ne kemi venë armiqësi dhe mëri midis tyre

قُلْ هَلْ أُنَبِّئُكُمْ بِشَرِّ مِّنْ ذَلِكَ مَثُوبَةً  
عِنْدَ اللَّهِ ۗ مَنْ لَعَنَهُ اللَّهُ وَغَضِبَ عَلَيْهِ  
وَجَعَلَ مِنْهُمْ الْقِرَدَةَ وَالْخَنَازِيرَ وَعَبَدَ  
الطَّاغُوتَ ۗ أُولَٰئِكَ شَرٌّ مَّكَانًا وَأَضَلُّ  
عَنْ سَوَاءِ السَّبِيلِ ۝۱۱

وَإِذَا جَاءُوكُمْ قَالُوا آمَنَّا وَقَدْ دَخَلُوا  
بِالْكُفْرِ وَهُمْ قَدْ خَرَجُوا بِهِ ۗ وَاللَّهُ أَعْلَمُ  
بِمَا كَانُوا يَكْتُمُونَ ۝۱۲

وَتَرَىٰ كَثِيرًا مِنْهُمْ يُسَارِعُونَ فِي الْأَثْمِ  
وَالْعُدْوَانِ وَأَكَلِهِمُ السُّحْتُ ۗ لَيْسَ مَا  
كَانُوا يَعْمَلُونَ ۝۱۳

لَوْ لَا يَنْهَاهُمُ الرَّبِّيُّونَ وَالْأَجْبَارُ عَنْ  
قَوْلِهِمُ الْأَثْمَ وَأَكَلِهِمُ السُّحْتُ ۗ لَيْسَ  
مَا كَانُوا يَصْنَعُونَ ۝۱۴

وَقَالَتِ الْيَهُودُ يَدُ اللَّهِ مَغْلُولَةٌ غُلَّتْ  
أَيْدِيهِمْ وَلَعْنُوا بِمَا قَالُوا ۗ بَلْ يَدُ  
مَبْسُوطَتِنَ لَا يَنْفِقُ كَيْفَ يَشَاءُ ۗ وَلَيَزِيدَنَّ  
كَثِيرًا مِنْهُمْ مَا أُنزِلَ إِلَيْكَ مِنْ رَبِّكَ  
طُغْيَانًا وَكُفْرًا ۗ وَالْقَيْنَا بَيْنَهُمُ الْعِدَاةَ  
وَالْبَغْضَاءَ إِلَى يَوْمِ الْقِيَامَةِ ۗ كُلَّمَا أَوْقَدُوا

وَقَالَتِ

21. Lexoni 2:66.

deri në Ditën e Kiametit.<sup>22</sup> Sa herë që ata ndezin zjarr për luftë, Allahu e shuan atë. Ata orvaten për të bërë trazira në tokë. Dhe Allahu nuk i do ata që bëjnë trazira.

66. Nëse ithtarët e Librit do të besonin e të druheshin (ndaj Zotit), patjetër që do t'ua zhduknim ligësitë dhe do t'i shpinim ata në kopshte bekimesh.

67. Dhe nëse ata do të zbatonin Teuratin dhe Inxhilin dhe çdo gjë që u është zbritur nga Zoti i tyre, do të hanin edhe nga ajo sipër tyre, edhe nga ajo nën këmbët e tyre. Prej tyre ka një grup të përmbajtur, por sa keq veprojnë shumica e tyre!

68. O i Dërguar! Kumtoje atë që të është zbritur ty prej Zotit tënd! Nëse nuk do ta bësh këtë, nuk e ke kumtuar mesazhin e Tij. Allahu do të të mbrojë nga njerëzit. Pa dyshim, Allahu nuk e udhëzon popullin mohues.

69. Thuaju: O ithtarët e Librit! Nuk qëndroni mbi asgjë derisa nuk zbatoni Teuratin, Inxhilin dhe atë që ju është zbritur prej Zotit tuaj. Ajo që të është zbritur ty prej Zotit tënd, do t'i shtojë shumicës prej tyre vetëm rebelimin dhe mohimin. Prandaj, mos të të vijë keq për popullin mohues.

نَارًا لِلْحَرْبِ أَطْفَاهَا اللَّهُ وَيَسْعُونَ  
فِي الْأَرْضِ فَسَادًا وَاللَّهُ لَا يُحِبُّ  
الْمُفْسِدِينَ ﴿٦٥﴾

وَلَوْ أَنَّ أَهْلَ الْكِتَابِ آمَنُوا وَاتَّقَوْا  
لَكَفَّرْنَا عَنْهُمْ سَيِّئَاتِهِمْ وَلَا دَخَلْنَا لَهُمْ جَنَّةَ  
النَّعِيمِ ﴿٦٦﴾

وَلَوْ أَنَّهُمْ أَقَامُوا التَّوْرَةَ وَالْإِنْجِيلَ وَمَا  
أُنزِلَ إِلَيْهِمْ مِنْ رَبِّهِمْ لَأَكْفُؤا مِنْ  
فَوْقِهِمْ وَمِنْ تَحْتِ أَرْجُلِهِمْ مِنْهُمْ  
أُمَّةٌ مُقْتَصِدَةٌ وَكَثِيرٌ مِنْهُمْ سَاءَ مَا  
يَعْمَلُونَ ﴿٦٧﴾

يَا أَيُّهَا الرَّسُولُ بَلِّغْ مَا أُنزِلَ إِلَيْكَ مِنْ  
رَبِّكَ وَإِنْ لَمْ تَفْعَلْ فَمَا بَلَّغْتَ رَسُولَتَهُ  
وَاللَّهُ يَعْصَمُكَ مِنَ النَّاسِ إِنَّ اللَّهَ لَا  
يَهْدِي الْقَوْمَ الْكَافِرِينَ ﴿٦٨﴾

قُلْ يَا أَهْلَ الْكِتَابِ لَسْتُمْ عَلَى شَيْءٍ حَتَّى  
تُقِيمُوا التَّوْرَةَ وَالْإِنْجِيلَ وَمَا أُنزِلَ  
إِلَيْكُمْ مِنْ رَبِّكُمْ وَلَيَزِيدَنَّ كَثِيرًا  
مِنْهُمْ مَا أُنزِلَ إِلَيْكَ مِنْ رَبِّكَ طُغْيَانًا  
وَكُفْرًا فَلَا تَأْسَ عَلَى الْقَوْمِ الْكَافِرِينَ ﴿٦٩﴾

22. Lexoni 5:15.

70. Sigurisht, ata që besuan, ata që janë hebrej, *sabi'inët*, të krishterët, cilido prej tyre që besoi Allahun dhe Ditën e *Ahiretit* dhe bëri të mira, nuk do të ketë as frikë dhe as nuk do të pikëllohet.<sup>23</sup>

71. Sigurisht, kemi marrë besëlidhjen e bijve të Izraelit dhe u kemi sjellë të Dërguar. Çdo herë që u vinin të Dërguar që nuk u pëlqenin, disa i quanin gënjeshtarë, disa i vrisnin.<sup>24</sup>

72. Ata menduan se nuk do të ndodhë asnjë sprovë. U verbuan dhe u shurdhuan. Pastaj, Allahu ua pranoi pendesën duke i mëshiruar. Por, shumica prej tyre, sërish u verbuan dhe u shurdhuan. Allahu e vështron punën që ata bëjnë.

73. Sigurisht, kanë mohuar ata që thanë: “Allahu është Mesihu, biri i Merjemes”. Kurse Mesihu tha: O bijtë e Izraelit! Adhuroni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj! Pa dyshim, atij që i atribuon ortak Allahut, Allahu ia ka ndaluar xhenetin. Streha e tij do të jetë zjarri. Të padrejtët nuk do të kenë asnjë ndihmës.

74. Sigurisht, kanë mohuar (edhe) ata që thanë: “Allahu është njëri prej treve”. Nuk ka të adhureshëm tjetër përveç të Adhureshmit të Vetëm. Dhe nëse ata nuk tërhiqen nga ajo që

إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَالَّذِينَ هَادُوا وَالصَّابِقُونَ  
وَالنَّصْرَىٰ مَنْ آمَنَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ  
وَعَمِلَ صَالِحًا فَلَا خَوْفَ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ  
يَحْزَنُونَ ﴿٧٠﴾

لَقَدْ أَخَذْنَا مِيثَاقَ بَنِي إِسْرَائِيلَ وَارْسَلْنَا  
إِلَيْهِمْ رُسُلًا ۖ كَلَّمَا جَاءَهُمْ رَسُولٌ بِمَالَا  
تَهْوَىٰ أَنفُسَهُمْ ۖ فَرِيقًا كَذَّبُوا وَفَرِيقًا  
يَقْتُلُونَ ﴿٧١﴾

وَحَسِبُوا أَنَّهُ لَا تَكُونُ فِتْنَةٌ ۖ فَعَمُوا وَصَمُوا  
ثُمَّ تَابَ اللَّهُ عَلَيْهِمْ ثُمَّ عَمُوا وَصَمُوا  
كَثِيرٌ مِنْهُمْ ۖ وَاللَّهُ بَصِيرٌ بِمَا يَعْمَلُونَ ﴿٧٢﴾

لَقَدْ كَفَرَ الَّذِينَ قَالُوا إِنَّ اللَّهَ هُوَ الْمَسِيحُ  
ابْنُ مَرْيَمَ ۖ وَقَالَ الْمَسِيحُ بَنِي إِسْرَائِيلَ  
اعْبُدُوا اللَّهَ رَبِّي وَرَبَّكُمْ ۖ إِنَّهُ مَنْ يُشْرِكْ  
بِاللَّهِ فَقَدْ حَرَّمَ اللَّهُ عَلَيْهِ الْجَنَّةَ وَمَأْوَاهُ  
النَّارُ ۖ وَمَا لِلظَّالِمِينَ مِنْ أَنْصَارٍ ﴿٧٣﴾

لَقَدْ كَفَرَ الَّذِينَ قَالُوا إِنَّ اللَّهَ ثَلَاثٌ  
ثَلَاثَةٌ ۖ وَمَا مِنْ إِلَهٍ إِلَّا إِلَهٌ وَاحِدٌ ۚ وَإِنْ  
لَمْ يَنْتَهُوا عَمَّا يَقُولُونَ لَيَمَسَّنَّ الَّذِينَ

23. Lexoni 2:63.

24. Lexoni 3:113.

thonë, mohuesit prej tyre, do t'i zërë pashmangshmërisht një ndëshkim i dhimbshëm.

كَفَرُوا مِنْهُمْ عَذَابَ آلِيمٍ ﴿٤١﴾

75. A nuk do të pendohen pranë Allahut dhe a nuk do t'i kërkojnë falje? Kurse Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

أَفَلَا يَتُوبُونَ إِلَى اللَّهِ وَيَسْتَغْفِرُونََهُ ۗ  
وَاللَّهُ غَفُورٌ رَحِيمٌ ﴿٧٥﴾

76. Mesihu, biri i Merjemes ishte vetëm një i Dërguar. Të Dërguarit para tij kanë kaluar. Nëna e tij ishte e ndershme. Ata të dy hanin ushqim. Shiko se si ua shpjegojmë qartë ajetet dhe shiko se ku humbin ata!<sup>25</sup>

مَا الْمَسِيحُ ابْنُ مَرْيَمَ إِلَّا رَسُولٌ قَدْ خَلَتْ مِنْ قَبْلِهِ الرُّسُلُ وَأُمُّهُ صِدِّيقَةٌ ۗ كَانَا يَأْكُلَنِ الطَّعَامَ ۗ أَنْظُرْ كَيْفَ نَبِّئِينَ لَهُمُ الْآيَاتِ ثُمَّ أَنْظِرْ آلِي يُؤْفَكُونَ ﴿٧٦﴾

77. Thuaju: Duke lënë Allahun, a adhuroni diçka që nuk ka fuqi as t'ju sjellë dëm e as dobi?! Kurse Allahu është Gjithëdhëgues, i Gjithëdijshëm.

قُلْ أَتَعْبُدُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ مَا لَا يَمْلِكُ لَكُمْ ضَرًّا وَلَا نَفْعًا ۗ وَاللَّهُ هُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ ﴿٧٧﴾

78. Thuaju: O ithtarët e Librit! Mos e teproni në fenë tuaj në mënyrë të padrejtë dhe mos ndiqni dëshirat e një populli, që ka devijuar më parë dhe i devijoi shumë të tjerë! Ata kanë humbur nga rruga e drejtë.

قُلْ يَا أَهْلَ الْكِتَابِ لَا تَغْلُوا فِي دِينِكُمْ غَيْرِ الْحَقِّ وَلَا تَتَّبِعُوا أَهْوَاءَ قَوْمٍ قَدْ ضَلُّوا مِنْ قَبْلُ وَأَصْلُوا كَثِيرًا ۗ وَضَلُّوا عَنْ سَوَاءِ السَّبِيلِ ﴿٧٨﴾

79. Ata që mohuan nga bijtë e Izraelit u mallkuan nga gjuha e Davudit dhe e Isait të birit të Merjemes. Kjo ndodhi për shkak se ata u treguan të

لُعِنَ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ بَنِي إِسْرَائِيلَ عَلَى لِسَانِ دَاوُدَ وَعِيسَى ابْنِ مَرْيَمَ ۗ ذَٰلِكَ بِمَا

25. Të gjithë Profetët e Zotit dhe *evlijatë* janë të pastër nga prekja e djallit. Arsyeya pse Kurani e përmendi në mënyrë të veçantë *Hazret Isain*<sup>as</sup> dhe nënën e tij, është që ata u përballën me një akuzë të rëndë, me të cilën ndonjë Profet tjetër nuk u përball. Përveç kësaj, ky ajete kur lexohet bashkë me ajetin ku Zoti pohon se asnjë profet nuk ka pasur trup të pavarur ndaj ushqimit dhe as nuk qe i përjetshëm (21:9), qartazi provon se *Hazret Isai*<sup>as</sup> ka ndërruar jetë. Sepse për sa kohë që ai ushqehet dikur dhe nuk ushqehet tani, do të thotë se ai nuk është më me trupin e tij tokësor. Andaj, ngritja e tij e përmendur në Kuran (4:159), është ngritje në grada, dhe jo ngritje fizike. Lexoni 21:9.

pabindshëm dhe se e tepronin.

80. Nuk tërhiqeshin nga ligësia që bënë. Sa e keqe ishte ajo që bënë!

81. Shumë prej tyre do t'i gjesh duke bërë miq ata që mohuan. Është shumë e keqe ajo që ata dërguan përpara për veten e tyre, saqë, Allahu iu zemërua ashpër dhe ata do të mbesin gjatë në ndëshkim.

82. Po ta besonin Allahun, Profetin dhe atë që i është zbritur atij, nuk do t'i bënë miq ata. Por, shumica prej tyre janë të padëgjueshëm.

83. Njerëzit më të ashpër në armiqësi me ata që besuan, do t'i gjesh judenjtë dhe idhujtarët. Dhe më të afërt në dashuri me ta do t'i gjesh ata që thanë: “jemi të krishterë”. Kjo sepse pikërisht prej tyre ka që janë të përshpirtshëm dhe murgj dhe se ata nuk janë mendjemëdhën.

Xhuzi 7

84. Dhe kur e dëgjojnë atë që i është zbritur të Dërguarit, do të shohësh se atyre u lotojnë sytë, për shkak të së vërtetës që ata njohën. Thonë: “O Zoti ynë! Ne besuam, andaj, na shkruaj ndër dëshmitarët!

85. E përse të mos e besojmë Allahun dhe të vërtetën që na ka ardhur, përderisa dëshirojmë fort që Zoti ynë të na pranojë në grupin e njerëzve të dëlirë?!”

عَصَوْا وَكَانُوا يَعْتَدُونَ ﴿٧٩﴾

كَانُوا لَا يَتَنَاهَوْنَ عَنْ مُنْكَرٍ فَعَلُوهُ ۗ

لَيْسَ مَا كَانُوا يَفْعَلُونَ ﴿٨٠﴾

تَرَى كَثِيرًا مِنْهُمْ يَتَوَلَّوْنَ الَّذِينَ كَفَرُوا ۗ

لَيْسَ مَا قَدَّمَتْ لَهُمْ أَنفُسُهُمْ أَنْ سَخِطَ

اللَّهُ عَلَيْهِمْ وَفِي الْعَذَابِ لَهُمْ خُلْدٌ ﴿٨١﴾

وَلَوْ كَانُوا يُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالتَّحِيٍّ وَمَا أُنزِلَ

إِلَيْهِ مَا اتَّخَذُوهُمْ أَوْلِيَاءَ وَلَكِنَّ كَثِيرًا

مِنْهُمْ فَسِقُونَ ﴿٨٢﴾

لَتَجِدَنَّ أَشَدَّ النَّاسِ عَدَاوَةً لِلَّذِينَ آمَنُوا

الْيَهُودَ وَالتَّذِينَ أَشْرَكُوا ۗ وَلَتَجِدَنَّ أَقْرَبَهُمْ

مَوَدَّةً لِلَّذِينَ آمَنُوا الَّذِينَ قَالُوا إِنَّا نَصْرِي ۗ

ذَلِكَ بِأَنَّ مِنْهُمْ قِسِيَسِينَ وَرُهْبَانًا

وَإِنَّهُمْ لَا يَسْتَكْبِرُونَ ﴿٨٣﴾

وَإِذَا سَمِعُوا مَا أُنزِلَ إِلَى الرَّسُولِ تَرَى

أَعْيُنَهُمْ تَفِيضُ مِنَ الدَّمْعِ مِمَّا عَرَفُوا مِنَ

الْحَقِّ ۗ يَقُولُونَ رَبَّنَا آمَنَّا فَاكْتُبْنَا مَعَ

الشَّاهِدِينَ ﴿٨٤﴾

وَمَا لَنَا لَا نُؤْمِنُ بِاللَّهِ وَمَا جَاءَنَا مِنَ

الْحَقِّ ۗ وَنَطْمَعُ أَنْ يُدْخِلَنَا رَبَّنَا مَعَ الْقَوْمِ

الصَّالِحِينَ ﴿٨٥﴾

86. Atëherë për atë që e thanë, Allahu i shpërbleu me xhenete, në të cilat rrjedhin lumenj, ku ata do të jetojnë përherë. Kështu është shpërblimi i mirëbërësve.

87. Dhe ata që mohuan dhe i quajtën gënjeshtër ajetet Tona, janë banorë të xhehenemit.

88. O ju që besuat! Mos i ndaloni të pastërtat që Allahu ju ka lejuar dhe mos e teproni. Allahu përnjëmend nuk i do ata që e teprojnë.

89. Dhe hani nga ajo që ju ka dhënë Allahu, të lejuara, të pastra. Kini drojë ndaj Allahut, të cilin e besoni.

90. Allahu nuk ju zë për betimet tuaja të kota, por ju zë për betimet tuaja të qëllimta. (Nëse e thyen betimin), shlyerja e tij është ushqimi i dhjetë të varfërve me një mesatare që ju ushqeni familjen tuaj, ose veshmbathjet e tyre, ose lirimi i një të robëruari. Ai që nuk ka mundësi për këtë, le të agjërojë tri ditë. Kjo është shlyerja e premtimeve tuaja, për të cilat u betuat. Ruajini betimet tuaja! Kështu jua shpjegon qartë Allahu ajetet e Tij, që të jeni mirënjohës.<sup>26</sup>

91. O ju që besuat! Sigurisht, (lëndët) dehëse, bixhozi, idhujt dhe shigjetat e fatit janë ndyrësi nga vepra e djallit.

فَأَنبَاهُهُمُ اللَّهُ بِمَا قَالُوا جَنَّتٍ تَجْرِي مِنْ  
تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا ۗ وَذَلِكَ جَزَاءُ  
الْمُحْسِنِينَ ﴿٨٦﴾

وَالَّذِينَ كَفَرُوا وَكَذَّبُوا بِآيَاتِنَا أُولَٰئِكَ  
أَصْحَابُ الْجَحِيمِ ﴿٨٧﴾

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَحْرِمُوا طَيِّبَاتِ مَا  
أَحَلَّ اللَّهُ لَكُمْ وَلَا تَعْتَدُوا ۗ إِنَّ اللَّهَ لَا  
يُحِبُّ الْمُعْتَدِينَ ﴿٨٨﴾

وَكُلُوا مِمَّا رَزَقَكُمُ اللَّهُ حَلَالًا طَيِّبًا ۗ وَاتَّقُوا  
اللَّهَ الَّذِي أَنْتُمْ بِهِ مُؤْمِنُونَ ﴿٨٩﴾

لَا يُؤَاخِذُكُمُ اللَّهُ بِاللَّغْوِ فِي أَيْمَانِكُمْ  
وَلَكِنْ يُؤَاخِذُكُمْ بِمَا عَقَّدْتُمُ الْأَيْمَانَ ۖ  
فَكَفَّارَتُهُ إِطْعَامُ عَشْرَةِ مَسْكِينٍ مِنْ  
أَوْسَطِ مَا تَطْعَمُونَ أَهْلِيكُمْ أَوْ كِسْوَتُهُمْ  
أَوْ تَحْرِيرُ رَقَبَةٍ ۗ فَمَنْ لَّمْ يَجِدْ فَصِيَامُ  
ثَلَاثَةِ أَيَّامٍ ۗ ذَلِكَ كَفَّارَةُ أَيْمَانِكُمْ إِذَا  
حَلَفْتُمْ ۗ وَاحْفَظُوا أَيْمَانَكُمْ ۗ كَذَلِكَ  
يُبَيِّنُ اللَّهُ لَكُمُ آيَاتِهِ لَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ ﴿٩٠﴾

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِنَّمَا الْخَمْرُ وَالْمَيْسِرُ  
وَالْأَنْصَابُ وَالْأَزْلَامُ رِجْسٌ مِنْ عَمَلِ

26. Betimet e kota do të thotë betime që njerëzit i bëjnë si shprehi në bisedat e përditshme, duke thënë “për Zotin!”. Allahu nuk do t’i ndëshkojë për betimet e tilla, por do t’u kërkojë llogari për betimet që i bëjnë me qëllim.



Prandaj, ruhuni nga ajo,<sup>27</sup> që të keni sukses.

الشَّيْطَانِ فَاجْتَنِبُوهُ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ ﴿١١﴾

92. Me anë të dehëses dhe të bixhozit, djalli do që të fusë armiqësi dhe urrejtje mes jush dhe t'ju pengojë nga përmendja e Allahut dhe nga namazi. Andaj, a po hiqni dorë (nga ato)?

إِنَّمَا يُرِيدُ الشَّيْطَانُ أَنْ يُوقَعَ بَيْنَكُمْ  
الْعَدَاوَةَ وَالْبَغْضَاءَ فِي الْخَمْرِ وَالْمَيْسِرِ  
وَيُصَدِّكُمْ عَنْ ذِكْرِ اللَّهِ وَعَنِ الصَّلَاةِ  
فَهَلْ أَنْتُمْ مُنْتَهُونَ ﴿١٢﴾

93. Dhe bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe ruhuni (nga e keqja)! Nëse e ktheni shpinën, dijeni se i Dërguari Ynë është i ngarkuar vetëm me kumtimin e qartë.

وَأَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ وَاحْذَرُوا  
فَإِنْ تَوَلَّيْتُمْ فَأَعْلَمُوا إِنَّمَا عَلَى رَسُولِنَا  
الْبَلَاغُ الْمُبِينُ ﴿١٣﴾

94. Ata që besuan dhe bënë të mira, nuk do të kenë asnjë gjynah në ato që hanë, me kusht që të kenë druajtje (ndaj Zotit), të besojnë, të bëjnë të mira, e sërish të kenë druajtje e të besojnë, dhe sërish të kenë druajtje dhe të bëjnë mirësi. Allahu i do mirëbërësit.<sup>28</sup>

لَيْسَ عَلَى الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ  
جُنَاحٌ فِيمَا طَعِمُوا إِذَا مَا اتَّقَوْا وَآمَنُوا  
وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ ثُمَّ اتَّقَوْا وَآمَنُوا  
ثُمَّ اتَّقَوْا وَ أَحْسَنُوا ۗ وَاللَّهُ يُحِبُّ  
الْمُحْسِنِينَ ﴿١٤﴾

95. O ju që besuat! Allahu patjetër do t'ju sprovtojë përmes gjahut, që e arrijnë duart dhe shtizat tuaja, në mënyrë që të dallojë atë që i frikësohet Atij kur është i vetëm. Ai që e kalon masën edhe pas kësaj, do të ketë ndëshkim të dhimbshëm.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لِيَبْلُوَنَّكُمْ اللَّهُ بَشْيَءٍ  
مِّنَ الصَّيْدِ تَنَالَهُ أَيْدِيكُمْ وَرِمَاحُكُمْ  
لِيَعْلَمَ اللَّهُ مَن يَخَافُهُ بِالْغَيْبِ ۚ فَمَن  
اعْتَدَىٰ بَعْدَ ذَلِكَ فَلَهُ عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿١٥﴾

27. Pra, nga vepra e djallit.

28. Ajeti parashtrohet tri faza të përparimit shpirtëror. Në fazën e parë, besimtarët kanë druajtje ndaj Zotit, besojnë dhe bëjnë vepra të mira. Në fazën e dytë ata kanë druajtje ndaj Zotit dhe besojnë, dhe besimi i tyre në këtë fazë është bërë aq i fortë sa që veprat e mira, si të thuasht, janë bërë pjesë e pandashme e besimit të tyre. Në fazën e tretë, ata kanë druajtje ndaj Zotit dhe bëhen mirëbërës (ata që kanë *ihsan*) deri në shkallën që arrijnë ta shohin Zotin e tyre duke bërë vepra të mira. Këtë shpjegim e jep Profeti Muhammed<sup>savs</sup> për fjalën *ihsan* (Buhari, nr. 50).

96. O ju që besuat! Mos vritni gjahun kur jeni në *Ihram*! Prej jush, ai që e vret me dashje duhet të dëmshpërblejë me një kurban, sipas gjykimit të dy njerëzve të drejtë prej jush me një kafshë sa ajo që është vrarë e që mund të çohet deri në Qabe; ose si shlyerje të ushqejë të varfrit, ose të agjërojë deri në atë masë, që ai ta ndiejë pasojën e veprimit të tij. Gjithçka që ka ndodhur në të kaluarën, Allahu e ka falur. Kurse ai që e përsërit, Allahu do të hakmerret me të. Allahu është Mbizotërues, Hakmarrës.

97. Ju lejohet gjuetia e detit dhe ushqimi i tij, si përfitim për ju dhe për udhëtarët. Kurse gjuetia në tokë ju është bërë e ndaluar gjersa të jeni në *Ihram*. Kini drojë ndaj Allahut, tek i cili do të tuboheni.

98. Allahu e bëri Qabenë, Shtëpinë e Shenjtë, si mjet ngritjeje (fetare dhe ekonomike) për njerëzit dhe, po ashtu, (për këtë qëllim i bëri) edhe muajt e shenjtë, kurbanet dhe kafshët me qafore si shenjë për kurban. Kjo që ta dini se Allahu e di mirë atë që gjendet në qiej dhe atë që gjendet në tokë dhe se Allahu është i Gjithëdijshëm për çdo gjë.

99. Dijeni që Allahu është i ashpër në ndëshkim dhe, gjithashtu, që Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَقْتُلُوا الصَّيْدَ وَأَنْتُمْ حُرْمٌ ۖ وَمَنْ قَتَلَهُ مِنْكُمْ مُتَعَمِّدًا فَجَزَاءٌ مِّثْلُ مَا قَتَلَ مِنَ النَّعْمِ يَحْكُمُ بِهِ ذَوَا عَدْلٍ مِنْكُمْ هَدِيًّا بِدَعْوِ الْكَعْبَةِ أَوْ كَفَّارَةٌ طَعَامُ مَسْكِينٍ أَوْ عَدْلٌ ذَلِكَ صِيَامًا لِيَذُوقَ وَبَالَ أَمْرِهِ ۗ عَفَا اللَّهُ عَمَّا سَلَفَ ۗ وَمَنْ عَادَ فَيَنْتَقِمُ اللَّهُ مِنْهُ ۗ وَاللَّهُ عَزِيزٌ ذُو انْتِقَامٍ ﴿٩٦﴾

أَجَلٌ لَكُمْ صَيْدُ الْبَحْرِ وَطَعَامُهُ مَتَاعًا لَكُمْ وَلِلسَّيَّارَةِ ۚ وَحُرِّمَ عَلَيْكُمْ صَيْدُ الْبَرِّ مَا دُمْتُمْ حُرْمًا ۗ وَاتَّقُوا اللَّهَ الَّذِي إِلَيْهِ تُحْشَرُونَ ﴿٩٧﴾

جَعَلَ اللَّهُ الْكَعْبَةَ الْبَيْتَ الْحَرَامَ قِيَامًا لِلنَّاسِ وَالشَّهْرَ الْحَرَامَ وَالْهَدْيَ وَالْقَلَائِدَ ۗ ذَلِكَ لَتَعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ يَعْلَمُ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ وَأَنَّ اللَّهَ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ ﴿٩٨﴾

إِعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ شَدِيدُ الْعِقَابِ وَأَنَّ اللَّهَ عَفُورٌ رَحِيمٌ ﴿٩٩﴾

100. I Dërguari nuk është i ngarkuar, përveçse me kumtim. Allahu e di atë që e zbuloni, si dhe atë që e fshihni.

مَا عَلَى الرَّسُولِ إِلَّا الْبَلَاغُ ۗ وَاللَّهُ يَعْلَمُ مَا تُبْدُونَ وَمَا كُنتُمْ تَعْلَمُونَ ﴿١٠٠﴾

101. Thuaju: Nuk barazohet e papastra me të pastrën, edhe sikur të të mahnitë bollëku i së papastrës. Kini druajtje ndaj Allahut, o të mençur, që të fitoni.<sup>29</sup>

قُلْ لَا يَسْتَوِي الْخَبِيثُ وَالطَّيِّبُ وَلَوْ أَعْجَبَكَ كَثْرَةُ الْخَبِيثِ ۚ فَاتَّقُوا اللَّهَ ۚ إِنَّهُ بَالِغٌ أُولَى الْأَبَابِ لَعَلَّكُمْ تَفْلِحُونَ ﴿١٠١﴾

102. O ju që besuat! Mos pyesni për gjërat, të cilat nëse ju zbulohen, ju shqetësojnë. Po të pyesni rreth tyre gjatë zbritjes së Kuranit, do t'ju zbulohen. I ka anashkaluar Allahu ato. Allahu është shumë Falës, shumë i Përmbajtur.<sup>30</sup>

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَسْأَلُوا عَنَ أَشْيَاءَ إِن تُبَدِّلْكُمْ تَسْوِكُمْ ۚ وَإِن تَسْأَلُوا عَنْهَا حِينَ يُنزَّلَ الْقُرْآنُ تُبَدِّلْكُمْ ۗ عَفَا اللَّهُ عَنْهَا ۗ وَاللَّهُ غَفُورٌ حَلِيمٌ ﴿١٠٢﴾

103. Edhe para jush një popull ka pyetur për to dhe më pas u bë mohues i tyre.

قَدْ سَأَلَهَا قَوْمٌ مِّن قَبْلِكُمْ ثُمَّ أَصْبَحُوا بِهَا كَافِرِينَ ﴿١٠٣﴾

104. Allahu nuk bëri as ndonjë *Bahirë*, as *Saiba*, as *Vesila* e as *Ham*, por ata që mohuan, shpifin gënjeshtër mbi Allahun dhe shumica prej tyre nuk reflektojnë.<sup>31</sup>

مَا جَعَلَ اللَّهُ مِنْ بَحِيرَةٍ وَلَا سَابِغَةٍ وَلَا وَصِيلَةٍ وَلَا حَامِرٍ ۗ وَلَكِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا يَفْتَرُونَ عَلَى اللَّهِ الْكَذِبَ ۗ وَكَثُرُهُمْ لَا يَعْقِلُونَ ﴿١٠٤﴾

29. Duke qenë i ndikuar nga shoqëria ku jeton, njeriu është i prirë të ndjekë dhe të imitojë të tjerët, veçanërisht kur ata janë në shumicë. Ky ajlet na paralajmëron se nuk duhet të ndjekim verbërisht shumicën kur veprimi i tyre na rezulton i papastër, edhe pse në dukje mund të jetë i bukur dhe joshës.

30. Ndalimi për të kërkuar sqarime për disa gjëra është mëshirë për njerëzit dhe, gjithashtu, nxitje që ata vetë të gjykojnë sipas vendit dhe situatës. Por, gjatë zbritjes së Kuranit, disa njerëz bënin pyetje për gjëra të vogla dhe ishte e nevojshme që atyre t'u jepej një përgjigje, në të kundërt, pyetësit do të mendonin se shpallja e Zotit nuk u dhënka përgjigjet e pyetjeve që lindin në zemrat e njerëzve. Në ajetin vijues përmendet një popull i kaluar, të cilët, duke bërë pyetje të shumta gjatë zbritjes së shpalljes, e futën veten në vështirësi.

31. *Bahirë*: Në kohën paraprofetike, i thoshin asaj deveje, së cilës i shponin veshët. Ka qenë traditë tek arabët që, kur deveja pille dhjetë të vegjël, ia shponin veshët dhe e linin të lirë. Askush nuk i hipte e as nuk e ngarkonte me ndonjë barrë (Mufredat). *Saiba*: Deveja që lihej e

105. E kur u thuhet: “Ejani drejt asaj që zbriti Allahu dhe drejt të Dërguarit!”, ata thonë: “Neve na mjafton ajo në të cilën i kemi gjetur etërit tanë”. Vallë, edhe sikur etërit e tyre të mos dinin asgjë e të mos ishin të udhëzuar?!

106. O ju që besuat! Jeni përgjegjës për veten tuaj! Nuk mund t’ju dëmtojë ai që devijoi, nëse e keni marrë udhëzimin. Tek Allahu do të ktheheni të gjithë dhe Ai do t’ju njoftojë për atë që bënit.<sup>32</sup>

107. O ju që besuat! Kur juve ju afrohet vdekja, merrni dy dëshmitarë të drejtë prej jush gjatë bërjes së testamentit. Nëse jeni duke udhëtuar në tokë dhe ju zë fatkeqësia e vdekjes, mund të zgjidhni dy të tjerë që nuk janë prej jush. Ndalini pas namazit dhe nëse dyshoni (te ta), ata le të betohen për Allahun: “Nuk do të marrim asnjë çmim në këmbim të kësaj (dëshmie), edhe sikur (tjetri) të jetë i afërmi ynë dhe nuk do ta fshehim dëshminë e Allahut, në të

وَإِذَا قِيلَ لَهُمُ تَعَالَوْا إِلَىٰ مَا أَنْزَلَ اللَّهُ وَإِلَى الرَّسُولِ قَالُوا حَسْبُنَا مَا وَجَدْنَا عَلَيْهِ آبَاءَنَا ۗ أَوَلَوْ كَانَ آبَاؤُهُمْ لَا يَعْلَمُونَ شَيْئًا وَلَا يَهْتَدُونَ ﴿١٠٥﴾

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا عَلَيْكُمْ أَنْفُسَكُمْ لَا يَضُرُّكُمْ مَن ضَلَّ إِذَا اهْتَدَيْتُمْ ۗ إِلَى اللَّهِ مَرْجِعُكُمْ جَمِيعًا فِيمَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ ﴿١٠٦﴾

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا شَهَادَةٌ بَيْنَكُمْ إِذَا حَضَرَ أَحَدُكُمُ الْمَوْتُ حِينَ الْوَصِيَّةِ اثْنَانِ ذَوَا عَدْلٍ مِّنكُمْ أَوْ آخَرَانِ مِنْ غَيْرِكُمْ إِنْ أَنْتُمْ صَرَبْتُمْ فِي الْأَرْضِ فَأَصَابَكُمْ مِصِيبَةُ الْمَوْتِ ۗ تَحْبِسُونَهُمَا مِنْ بَعْدِ الصَّلَاةِ فَيُقْسِمُن بِاللَّهِ إِنْ ارْتَبْتُمْ لَا نَشْتَرِي بِهِ ثَمًّا وَلَوْ كَانَ ذَا قُرْبَىٰ ۗ وَلَا تَكُنْمُ شَهَادَةً

lirë në kullotë, pra, që nuk pengohej kur shkote qoftë te burimi i ujit, qoftë në kullotë. Arabët këtë e bënin atëherë, kur deveja të kishte pjellë pesë të vegjël. *Vesila*: Kur dhia pillte keçe binjakë, një mashkull dhe një femër, nuk thernin asnjërin prej tyre, sepse mendonin që nëse do ta thernin njërin, do ta shqetësonin tjetrin. *Ham*: Kau që sillte dhjetë vija me farën e tij. Ai nuk përdorej as për transport e as për punë të tjera dhe as nuk pengohej kur hynte në kullotë ose kur i afrohej burimit.

32. Ky ajet na mëson se ne më së pari duhet të përmirësohemi vetë. Sepse derisa ne vetë nuk fitojmë pëlqimin e Zotit përmes veprave tona, është e kotë t’i fitojmë të tjerët drejt pëlqimit të Tij. Njeriu që nuk ka dritë në shpirtin e tij, çfarë drite mund t’i japë tjetrit?! Ai që po rrëzohet për vete, çfarë mbështetje mund t’i sigurojë tjetrit?! Ai që vetë nuk është i pastër shpirtërisht, si mund të pastrojë të tjerët?! Por nëse ne bëhemi të pastër, të qëndrueshëm dhe dritëplotë, ndihma e Allahut do të na shoqërojë dhe askush nuk mund të na devijojë dot.

kundërt, ne pa dyshim do të jemi ndër mëkatarët”.

اللَّهُ إِنَّا إِذَا لَمِنَ الْأَثِمِينَ ﴿٧٧﴾

108. E nëse zbulohet që ata të dy kanë bërë mëkat, në vend të tyre, le të ngrihen dy të tjerë prej atyre, të cilëve ua morën të drejtën dy të parët dhe, le të betohen për Allahun: “Dëshmia jonë është më e drejtë sesa dëshmia e atyre të dyve dhe ne nuk e kemi tepruar, në rastin e kundërt, do të jemi vërtet mizorë”.

فَإِنْ عُثِرَ عَلَىٰ أَثَمًا اسْتَحَقَّ إِثْمًا فَآخَرَانِ  
يَقُومُونَ مَقَامَهُمَا مِنَ الَّذِينَ اسْتَحَقَّ عَلَيْهِمُ  
الْأُولَٰئِينَ فَيَقْسِمْنَ بِاللَّهِ لَشَهَادَتُنَا أَحَقُّ مِنْ  
شَهَادَتِهِمَا وَمَا اعْتَدَيْنَا ۗ إِنَّا إِذَا لَمِنَ  
الظَّالِمِينَ ﴿٧٨﴾

109. Kjo (mënyrë) është më e mundshme që dëshmia e të parëve të jetë e vërtetë ose ata të kenë frikë që betimi i tyre mund të rrëzohet nga betimi i (dy) të tjerëve. Kini drojë Allahun dhe dëgjoni (me vëmendje)! Allahu nuk i udhëzon njerëzit e pabindshëm.

ذٰلِكَ اَدْنٰى اَنْ يَّاتُوْا بِالشَّهَادَةِ عَلٰى وَجْهَهَا  
اَوْ يَخَافُوْا اَنْ تُرَدَّ اِيْمَانٌ بَعْدَ اِيْمَانِهِمْ ۗ  
وَاتَّقُوا اللّٰهَ وَاَسْمَعُوْا ۗ وَاللّٰهُ لَا يَهْدِي  
الْقَوْمَ الْفٰسِقِيْنَ ﴿٧٩﴾

110. Ditën kur Allahu do t'i mbledhë të Dërguarit dhe do t'i pyesë: “Ç’përgjigje keni marrë?”, ata do t'i thonë: “Nuk kemi dijeni. Sigurisht, Ti i di shumë mirë të gjitha fshehtësitë”.<sup>33</sup>

يَوْمَ يَجْمَعُ اللّٰهُ الرُّسُلَ فَيَقُوْلُ مَاذَا  
اٰجَبْتُمْ ۗ قَالُوْا لَا عِلْمَ لَنَا اِنَّكَ اَنْتَ  
عَلَّامُ الْغُيُوْبِ ﴿٨٠﴾

111. Kur Allahu tha: “O Isa i biri i Merjemes! Kujtoje bekimin Tim mbi ty dhe mbi nënën tënde! Kur të mbështeta me anë të Shpirtit të

اِذْ قَالَ اللّٰهُ يُعِيْسٰى ابْنَ مَرْيَمَ اذْكُرْ  
نِعْمَتِيْ عَلَيْكَ وَعَلٰى وَاٰلِكَ ۗ اِذْ اٰتٰتُكَ  
رُوحَ الْقُدُسِ ۗ تَكَلَّمُ النَّاسُ فِي الْمَهْدِ

33. Kjo padijeni e Profetëve është për atë pjesë të popullit të tyre që vjen pas vdekjes së tyre. Ajetet vijuese thonë se edhe *Hazret Isai*<sup>as</sup> do të pohojë “Kam qenë dëshmitar mbi ta derisa isha mes tyre” (5:118). Pra, nëse nuk kanë dijeni, nuk mund të bëhen as dëshmitarë. Në të njëjtën mënyrë, edhe Profeti Muhammed<sup>savs</sup> mund të tregojë padijeninë e tij për gjendjen e muslimanëve të sotëm, por jo të sahabëve me të cilët ai bashkëjetoj, sepse ishte dëshmitar i gjendjes së tyre. Andaj, kjo padijeni e të Dërguarve lidhet vetëm me atë pjesë të *umetit* të tyre, që vjen pas vdekjes së tyre ose në ditët e largimit të tyre nga kjo botë.

shenjtë. Ti u flisje njerëzve në djep e në parapleqëri. Dhe kur të mësova Librin, urtësinë, Teuratin dhe Inxhilin. Kur krijote nga balta një formë shpendi me urdhrin Tim, e më pas fryje në të dhe ajo bëhej shpend me urdhrin Tim, dhe shëroje të verbrin e lindur dhe të lebrosurin me urdhrin Tim; kur i nxirrte të vdekurit me urdhrin Tim. Po ashtu (kujtoje) kur Unë i pengova bijtë e Izraelit kundër teje,<sup>34</sup> kur ti ua solle shenjat e qarta dhe mohuesit prej tyre thanë: “Kjo është vetëm një magji e hapët!”<sup>35</sup>

112. E kur u kam dërguar shpallje dishepujve: “Më besoni mua dhe të Dërguarin Tim”, ata thanë: “Ne besuam dhe shëno që jemi të nënshtruar”.

113. Kur dishepujt thanë: “O Isa i biri i Merjemes! Zoti yt, a mundet të na zbresë një sofër prej qiellit?”, ai u tha: “Kini drojë ndaj Allahut, nëse jeni besimtarë!”

114. Ata thanë: “Duam që të hamë prej saj, të na qetësohen zemrat, ta dimë se ke thënë të vërtetën dhe ne të jemi dëshmitarë për këtë”.

115. Isai i biri i Merjemes tha: “O Allah, Zoti ynë! Na zbrit një sofër prej qiellit, që ajo të na bëhet festë, për të parin tonë dhe për të fundmin

وَكَهَلًا ۚ وَإِذْ عَلَّمْتُكَ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ  
وَالتَّوْرَةَ وَالْإِنْجِيلَ ۚ وَإِذْ تَخْلُقُ مِنَ  
الطِّينِ كَهَيْئَةِ الطَّيْرِ بِإِذْنِي فَتَنْفُخُ فِيهَا  
فَتَكُونُ طَيْرًا بِإِذْنِي وَتُبْرِئُ الْأَكْمَةَ  
وَالْأَبْرَصَ بِإِذْنِي ۚ وَإِذْ تُخْرِجُ الْمَوْتَى  
بِإِذْنِي ۚ وَإِذْ كَفَّمْتُ بَنِي إِسْرَائِيلَ عَنْكَ  
إِذْ جِئْتَهُمْ بِالْبَيِّنَاتِ فَقَالَ الَّذِينَ كَفَرُوا  
مِنْهُمْ إِنْ هَذَا إِلَّا سِحْرٌ مُّبِينٌ ﴿٣٥﴾

وَإِذْ أَوْحَيْتُ إِلَى الْحَوَارِيِّينَ أَنْ أُمُّوا  
بِي وَرَسُولِي ۚ قَالُوا آمَنَّا وَاشْهَدْ بِأَنَّا  
مُسْلِمُونَ ﴿٣٦﴾

إِذْ قَالَ الْحَوَارِيُّونَ يُعِيسَى ابْنُ مَرْيَمَ  
هَلْ يَسْتَطِيعُ رَبُّكَ أَنْ يُنَزِّلَ عَلَيْنَا مَائِدَةً  
مِّنَ السَّمَاءِ ۗ قَالَ اتَّقُوا اللَّهَ إِنْ كُنْتُمْ  
مُؤْمِنِينَ ﴿٣٧﴾

قَالُوا نُرِيدُ أَنْ نَأْكُلَ مِنْهَا وَنَطْفِئَ قُلُوبَنَا  
وَنَعْلَمَ أَنْ قَدْ صَدَقْتَنَا وَنَكُونَ عَلَيْهَا مِنَ  
الشَّاهِدِينَ ﴿٣٨﴾

قَالَ عِيسَى ابْنُ مَرْيَمَ اللَّهُمَّ رَبَّنَا أَنْزِلْ  
عَلَيْنَا مَائِدَةً مِنَ السَّمَاءِ تَكُونُ لَنَا عِيدًا  
لِّأَوْلِيَانَا وَآخِرِنَا وَآيَةً مِنْكَ ۚ وَارْزُقْنَا وَأَنْتَ

34. Ajeti i referohet tentativës së hebrenjve për të vrrarë Hazret Isain<sup>as</sup> në kryq, prej të cilit Zoti e shpëtoi atë. Lexoni 4:159.

35. Lexoni shpjegimin te 3:50.

tonë dhe të jetë shenjë prej Teje; na furnizo, dhe Ti je Furnizuesi më i mirë!”<sup>36</sup>

116. Allahu i tha: “Unë sigurisht që do ta zbres atë mbi ju. Dhe pas kësaj, kushdo prej jush që do të mohojë, Unë do ta ndëshkoj në atë mënyrë që nuk do të ndëshkoj askënd tjetër në botë”.

117. Dhe kur Allahu i tha: “O Isa i biri i Merjemes! A ti u the njerëzve – më adhuroni mua dhe nënën time si dy zota pos Allahut – ?”, ai tha: “Je i Shenjtë! Nuk mund të them diçka që nuk kam të drejtë. Po ta kisha thënë këtë, Ti me siguri do ta dije. Ti e di atë që është në veten time dhe unë nuk e di atë që është në Vetën Tënde. Sigurisht, Ti i di shumë mirë të gjitha fshehtësitë.

118. Nuk u kam thënë atyre asgjë tjetër përveç asaj që më urdhërove – adhurojeni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj – Kam qenë dëshmitar mbi ta derisa isha mes tyre. Dhe kur ma more shpirtin, Ti ishe Mbikëqyrësi i tyre. Ti je Dëshmitar mbi çdo gjë.<sup>37</sup>

36. Do të kishte dy periudha prosperiteti dhe përparimi për popujt e krishterë, siç tregon fjala *id* (festë), që fjalë për fjalë do të thotë “ditë feste që kthehet”. Popujt e krishterë patën me bollëk të mirat e kësaj bote në periudhën e hershme pas Konstandinit. Më pas, në shekujt e fundit ata sërish patën begati materiale dhe madhështi politike në atë masë sa nuk ka të ngjashme në historinë e asnjë populli tjetër.

37. Për aq kohë sa *Hazret Isai*<sup>as</sup> ishte gjallë, ai kujdesej me vëmendje për ndjekësit e tij që ata të mos devijonin nga rruga e drejtë, por ai nuk do të dinte se si silleshin dhe çfarë doktrinash të gabuara do të praktikonin ndjekësit pas vdekjes së tij. Tani, siç e pohon edhe Kurani, pasi ndjekësit e tij kanë humbur rrugën, rrjedhimisht edhe *Hazret Isai*<sup>as</sup> ka ndërruar jetë, sepse, siç e thekson ky ajet, se ai do të adhurohej si Zot pas vdekjes së tij. Përveç kësaj, fakti që ky

حَيْرِ الرَّزِيقِينَ ﴿١١٥﴾

قَالَ اللَّهُ إِنِّي مُنَزِّلُهَا عَلَيْكُمْ ۖ فَمَنْ يَكْفُرْ  
بَعْدَ مِنْكُمْ فَإِنِّي أُعَذِّبُهُ عَذَابًا لَا أُعَذِّبُهُ  
بِغَيْرِ أَحَدٍ مِّنَ الْعَالَمِينَ ﴿١١٦﴾

وَإِذْ قَالَ اللَّهُ لِعِيسَى ابْنَ مَرْيَمَ آنتَ  
قُلْتَ لِلنَّاسِ اتَّخِذُونِي وَأُمَّيَ الْهَيْدِينَ مِنْ  
دُونِ اللَّهِ ۗ قَالَ سُبْحَانَكَ مَا يَكُونُ لِي  
أَنْ أَقُولَ مَا لَيْسَ لِي بِحَقِّ ۗ إِنْ كُنْتُ  
قُلْتُهُ فَقَدْ عَلِمْتَهُ ۗ تَعَلَّمَ مَا فِي نَفْسِي  
وَلَا أَعْلَمُ مَا فِي نَفْسِكَ ۗ إِنَّكَ أَنْتَ  
عَلَّامُ الْغُيُوبِ ﴿١١٧﴾

مَا قُلْتُ لَهُمْ إِلَّا مَا أَمَرْتَنِي بِهِ إِنْ أَعْبُدُوا  
اللَّهَ رَبِّي وَرَبَّكُمْ ۖ وَكُنْتُ عَلَيْهِمْ شَهِيدًا  
مَا دُمْتُ فِيهِمْ ۗ فَلَمَّا تَوَفَّيْتَنِي كُنْتُ أَنْتَ  
الرَّقِيبَ عَلَيْهِمْ ۗ وَأَنْتَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ  
شَهِيدٌ ﴿١١٨﴾

119. Nëse do t'i ndëshkosh, janë robërit e Tu, e nëse do t'i falësh, Ti sigurisht je Mbizotëruesi, i Urti!”

120. Allahu tha: “Kjo është dita, kur të sinqertëve do t'u bëjë dobi sinqeriteti i tyre. Për ta ka kopshte në të cilat rrjedhin lumenj. Ata atje do të jetojnë përgjithmonë. Allahu është i kënaqur me ta dhe ata janë të kënaqur me Atë. Kjo është fitorja madhore.

121. I Allahut është sundimi i qiejve, i tokës dhe i asaj që gjendet në to. Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë.<sup>38</sup>

إِنْ تُعَذِّبُهُمْ فَإِنَّهُمْ عَبَادُكَ ۗ وَإِنْ  
تَغْفِرَ لَهُمْ فَإِنَّكَ أَنْتَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ﴿١١٩﴾

قَالَ اللَّهُ هَذَا يَوْمٌ يَنْفَعُ الصَّادِقِينَ  
صِدْقُهُمْ ۗ لَهُمْ جَنَّاتٌ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا  
الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا أَبَدًا رَضِيَ اللَّهُ  
عَنْهُمْ وَرَضُوا عَنْهُ ۗ ذَلِكَ الْفَوْزُ  
الْعَظِيمُ ﴿١٢٠﴾

لِلَّهِ مُلْكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَا فِيهِنَّ ۗ  
وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿١٢١﴾

ajet na përshkruan sesi *Hazret Isai* do të shprehë padijeninë e tij që ndjekësit e tij e morën atë dhe nënën e tij për dy zota pos Allahut, dëshmon se ai nuk do të kthehet në këtë botë. Sepse, nëse kthehet, do të shohë me sytë e tij se pasuesit e tij e kanë hyznizuar atë, atëherë Ditën e Gjykimit, ai nuk mund të pretendojë përpara Zotit se nuk është në dijeni të këtij fakti. Një përgjigje e tillë do të përbente gënjeshtër përpara Allahut. Kështu, ky ajet vërteton qartazi se *Hazret Isai*<sup>as</sup> ka ndërruar jetë dhe se ai nuk do të kthehet më në këtë botë. Pikërisht kështu e ka kuptuar dhe shpjeguar këtë ajet edhe Profeti Muhammed<sup>savs</sup>. Në një hadith të famshëm përmendet që Ditën e Gjykimit Profeti<sup>savs</sup> kur do të shohë disa nga ndjekësit e tij duke kaluar në anën e xhehenemit, do të habitet se pse ata po shkojnë në atë anë. – Këta janë ata që kanë devijuar nga rruga e drejtë kur ti je ndarë nga ata –, do t'i thuhet Profetit<sup>savs</sup>. Duke iu referuar pikërisht këtij ajeti, Profeti<sup>savs</sup> do të thotë – Unë do të them ashtu siç tha robi i mirë Isai, biri i Merjemes: Kam qenë dëshmitar mbi ta derisa isha mes tyre. Dhe kur ma more shpirtin, Ti ishe Mbikëqyrësi i tyre. Ti je Dëshmitar mbi çdo gjë (Buhari, nr. 3447). Pra, ajeti dhe hadithi tregojnë se si *Hazret Isai*, ashtu edhe Profeti Muhammed<sup>savs</sup> kanë ndërruar jetë dhe gjithashtu, si *Hazret Isai*, ashtu edhe Profeti Muhammed<sup>savs</sup> Ditën e Gjykimit do të jenë në padijeni për sa i përket devijimit të ndjekësve të tyre përkatës. Ka edhe ajete të tjera në Kuran që pohojnë kategorikisht se *Hazret Isai*<sup>as</sup> ka vdekur dhe se ngritja e tij ndodhi jo fizikisht, por në grada (3:56; 4:158-159; 3:145; 21:9 etj.), andaj profecia për riardhjen e tij kurrsesi nuk mund të ishte në kuptimin e drejtpërdrejtë, por në kuptimin metaforik. Mesihu i Premtuar që do të vinte te muslimanët u quajt Isai biri i Merjemes për shkak të ngjashmërisë. Profeti<sup>savs</sup> gjithashtu parashikoi se muslimanët dhe ithtarët e Librit do t'i ngajjnë njëri-tjetrit (Tirmidhi, nr. 2641). Andaj, 14 shekuj pas Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, muslimanët do të ishin njësoj sikurse hebrenjtë e shekullit 14-të pas *Hazret Musait*<sup>as</sup>, në kohën kur atyre u erdhi Mesihu i tyre.

38. Ajeti përmban një vazhdim të goditur të sagës së zhvillimit dhe të rënies së popullit të krishterë që u përmend në këtë sure, dhe deklaroi se lavdia e tyre nuk është e përjetshme. Sundimi i përjetshëm i qiejve, i tokës dhe i gjithçkaje që kanë ato, i takon vetëm Allahut dhe Ai është i Plotfuqishëm t'ua mundësojë atë kujt të dojë.



## Surja 6 – El-En'am

Surja El-En'am është mekase dhe bashkë me *bismil-lahin*, ka njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë ajete.

Në ajetin e fundit të sures së mëparshme, u përmend që Allahu është Sunduesi i të gjitha botëve dhe i gjithçkaje që gjendet midis tyre, dhe po kjo përmendet edhe më qartë në fillim të kësaj sureje. Pra, thuhet që e gjithë lavdia është e Allahut, që krijoi qiejt dhe tokën dhe, gjithashtu, në rrugën e zbulimit të tyre pavarësisht se ka shumë errësira, Ai i dhuron njeriut largpamësinë, që i heq errësitat një nga një. Kështu, zhvillimi i shkencës në kohën e sotme, vazhdimisht i ngre perdet nga errësitat e krijimit të qiejve e të tokës, dhe njeriu fiton dije çdo ditë e më shumë për sekretet e tyre dhe të asaj që *gjendet midis tyre*. Çdo errësi të po kthehet në dritë.

Kjo sure, në fillim të saj, siç flet për largimin e errësirave të qiellit, po ashtu flet edhe për kthimin në dritë të errësirave të terikut e të detit. Gjithashtu, errësitat e shpirtave të njerëzve tërheqin ndëshkimet që u bien prej qiellit. Kjo temë përmendet në ajetin 66 të kësaj sureje.

Shkencëtarëve u bëhen dritë errësitat e qiejve e të tokës për shkak të kërkimeve të tyre, por robërve të zgjedhur të Zotit, si *Hazret Ibrahim*<sup>as</sup>, Allahu i Madhërisëm ua zbulon sundimin e qiejve e të tokës, duke u dërguar dritë prej qiellit, siç përmendet në ajetin 76 të kësaj sureje.

Kjo sure vazhdimisht flet për Profetët, për zbritjen e Librave dhe të dritës së udhëzimit mbi ta.

Po kjo sure flet se si Zoti i shpërthen farat e mbështjella dhe prej errësirave të tyre nxjerr jetë që lulëzon. Po ashtu, ajo flet edhe për yjet sesi ato udhëzojnë udhëtarët, duke zbardhur errësitat e tokës dhe të detit.

Në ajetet që pasojnë ajetin 96, Kurani i Shenjtë hedh dritë mbi një dukuri jashtëzakonisht të rëndësishme, duke thënë se me anë të gjelbërimit çahen farat e mbështjella, të cilat nxjerrin të gjitha llojet e frutave dhe thotë: Studioni procesin e pjekjes së këtyre frutave, sepse, për ata që besojnë në shenjat e Allahut, ka shumë shenja në të.

Gjelbërimi vjen nga klorofili, i cili në vetvete është një mrekulli dhe për të cilin, shkencëtarët nuk i kanë gjetur dot etapat e evolucionit. Kjo lëndë tejet e ndërlikuar, do t'i duhej jetës që në shkallën e parë të saj, dhe ajo do të shkaktonte edhe lindjen e njeriut në shkallët vijuese. Se si u bë evoluimi i klorofilit, kjo është ende e pazgjidhur. Ajo që na tërheq vëmendjen më shumë këtu, është fakti se klorofili bëhet me anë të dritës, e jo me anë të zjarrit. Tema e dritës, se çfarë zhvillimesh të jashtëzakonshme ka shkaktuar ajo nëpër qiej e në tokë, kulmohet në fund të kësaj sureje.

Kjo sure flet edhe për një sërë bestytish të vjetra të idhujtarëve që janë të lidhura me

bagëtitë, të cilat Zoti i Madhërishëm i kishte krijuar për jetën e njeriut, por idhujtarët, duke u përfshirë në doktrina nga më të ndryshmet, ua zbehën vlerat atyre.

Pjesa e fundit e kësaj sureje, jo vetëm që sqaron se çfarë është e lejuar dhe çfarë është e ndaluar nga bagëtitë, por hedh dritë edhe mbi instinktet e lejuara dhe të ndaluara. Me fjalë të tjera, bashkë me lejimin dhe ndalimin e ushqimeve për trupin, flitet edhe për të lejuarat dhe të ndaluarat për shpirtin.

Kjo sure na mëson të bëjmë mirësi ndaj prindërve, të cilët heqin shqetësime nga më të mëdhatë për fëmijët.

Në fund, kjo sure sjell një ajet që hedh dritë mbi nënshtrimin dhe mbi bindjen absolute të Profetit Muhammed<sup>savs</sup> ndaj Zotit të Madhërishëm. Përshkrim më i mirë sesa ky për bindjen absolute ndaj Zotit, mbase nuk është i mundur. Madje në asnjë nga Librat e mëparshëm nuk ka ndonjë varg të tillë për ndonjë profet tjetër. Zoti i Madhërishëm e urdhëron Profetin Muhammed<sup>savs</sup> të deklarojë: Namazet e mia, sakrificat e mia, (pra, jo vetëm ato të bagëtive, por edhe të ndjenjave), jeta ime dhe vdekja ime janë tërësisht të dedikuara për Allahun.

1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Lavdia është e Allahut, që krijoi qiejt dhe tokën dhe bëri errësirat dhe dritën, por ata që mohuan, i barazojnë (të tjerët) me Zotin e tyre.

أَلْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ  
وَجَعَلَ الظُّلُمَاتِ وَالنُّورَ ۚ ثُمَّ الَّذِينَ كَفَرُوا  
بِرَبِّهِمْ يَعْدِلُونَ ①

3. Është Ai që ju krijoi nga dheu, e më pas dekretoi një afat. Afati i caktuar është tek Ai, dhe ju prapëseprapë dyshoni.<sup>1</sup>

هُوَ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ طِينٍ ثُمَّ قَضَىٰ أَجَلَ ۗ  
وَأَجَلَ مُّسَمًّىٰ عِنْدَهُ ۚ ثُمَّ أَنْتُمْ تَمْتَرُونَ ①

4. Është Ai Allah në qiej e në tokë. Ai di edhe të fshehtën tuaj edhe të zbuluarën tuaj, dhe di çdo gjë që bëni.<sup>2</sup>

وَهُوَ اللَّهُ فِي السَّمَوَاتِ وَفِي الْأَرْضِ ۗ يُعَلِّمُ  
سِرِّكُمْ وَجَهْرَكُمْ وَيَعْلَمُ مَا تَكْسِبُونَ ①

5. Sa herë që u vjen ndonjë shenjë prej shenjave të Zotit të tyre, ata veçse ia kthejnë shpinën.

وَمَا تَأْتِيهِمْ مِنْ آيَةٍ مِنْ آيَاتِ رَبِّهِمْ إِلَّا  
كَانُوا عَنْهَا مُعْرِضِينَ ①

6. Kështu, ata e quajtën gënjeshtër të vërtetën, kur ajo u erdhi. Së

فَقَدْ كَذَّبُوا بِالْحَقِّ لَمَّا جَاءَهُمْ ۗ فَسَوْفَ

1. Në këtë ajet, fjala “afat” (arab. *exhel*) që përmendet në fillim, nënkupton vdekjen aksidentale ose vdekjen nga ndonjë sëmundje, afat i cili mund të bjerë përpara *afatit të caktuar*, ndërsa kjo e fundit llogaritet si jetëgjatësia e caktuar e njeriut. Kështu ndodh edhe në punët e kësaj bote. Siç për shembull, inxhinierët që caktojnë një afat për ndërtesat, urat, etj., që ndërtojnë duke pohuar se ato do të qëndrojnë kaq vite dhe më pas ato duhen rrezuar, por, ndonjëra prej tyre mund të rrëzohet edhe para kohe, për shkak të ndonjë aksidenti a fatkeqësie, duke u shkatërruar kështu përpara *afatit të caktuar*.

2. Pohimi që Allahu është “në qiej e në tokë”, nuk do të thotë se Qenia e Zotit fizikisht i përshkon qiejt dhe tokën, por se dija dhe fuqia e Tij e sundojnë të gjithë universin. Vetë Kurani e shpjegon këtë me fjalët që pasojnë, ku thotë se Ai ia di njeriut edhe të fshehtën, edhe të zbuluarën. Pra, Zoti është i Gjithëdijsëm edhe për botën lëndore, edhe për atë shpirtërore. Lexoni edhe 7:55.

shpejti atyre do t'u vijnë lajmet (e përmbushjes së fjalëve), që ata i përqeshnin.

7. A nuk kanë parë ata se sa shumë popuj përpara tyre kemi shkatërruar, të cilët i fuqizuar në tokë, sa nuk ju kemi fuqizuar ju, duke u dërguar retë që vazhdimisht u lëshonin shi dhe duke bërë lumenj për ta që rridhnin nën kontrollin e tyre?! Më pas i shkatërruam për shkak të mëkateve të tyre dhe, pas tyre, ngritëm popuj të tjerë.

8. Sikur të të zbrisnim ndonjë shkrim në letër, që ata edhe ta preknin me duart e tyre, prapëseprapë mohuesit patjetër do të thoshin: “Kjo është vetëm një magji e hapur!”

9. Ata thonë: “Pse nuk i zbret atij ndonjë engjëll?” Po nëse do ta zbrisnim ndonjë engjëll, do të mbyllej çështja, më pas atyre nuk do t'u jepej kohë.

10. Edhe sikur ta bënim engjëll, sërish si burrë do ta bënim, dhe ata do t'i linim në mëdyshje, ashtu siç janë në mëdyshje për këtë (çështje).

11. Edhe para teje janë përqeshur të Dërguarit. Por, cilët ndër ta përqeshën, i gjeti ajo që ata përqeshnin.

12. Thuaju: Udhëtoni nëpër tokë dhe shikoni se si ishte fundi i mohuesve!

يَأْتِيهِمْ أَنْبَاءُ مَا كَانُوا بِهِ يَسْتَهْزِءُونَ ﴿١٠﴾

لَمْ يَرَوْا كَمْ أَهْلَكْنَا مِنْ قَبْلِهِمْ مِنْ قَرْنٍ مَكَّيْتَهُمْ فِي الْأَرْضِ مَا لَمْ نَمُكِّنْ لَكُمْ وَأَرْسَلْنَا السَّمَاءَ عَلَيْهِمْ مِدْرَارًا وَجَعَلْنَا الْأَنْهَارَ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهِمْ فَأَهْلَكْنَاهُمْ بِذُنُوبِهِمْ وَأَنْشَأْنَا مِنْ بَعْدِهِمْ قَرْنًا آخَرِينَ ﴿١٠﴾

وَلَوْ نَزَّلْنَا عَلَيْكَ كِتَابًا فِي قِرْطَاسٍ فَلَمَسُوهُ بِأَيْدِيهِمْ لَقَالِ الَّذِينَ كَفَرُوا إِنَّ هَذَا إِلَّا سِحْرٌ مُبِينٌ ﴿١٠﴾

وَقَالُوا لَوْلَا أُنزِلَ عَلَيْهِ مَلَكٌ ۖ وَلَوْ أَنْزَلْنَا مَلَكَ لَقُضِيَ الْأَمْرُ ثُمَّ لَا يُنظَرُونَ ﴿١٠﴾

وَلَوْ جَعَلْنَاهُ مَلَكَ لَجَعَلْنَاهُ رَجُلًا وَلَلَبَسْنَا عَلَيْهِمْ مَا يَلْبِسُونَ ﴿١٠﴾

وَلَقَدْ اسْتَهْزَيْتُمْ بِرُسُلِي مِنْ قَبْلِكَ فَحَاقَ بِالَّذِينَ سَخِرُوا مِنْهُمْ مَا كَانُوا بِهِ يَسْتَهْزِءُونَ ﴿١١﴾

قُلْ سِيرُوا فِي الْأَرْضِ ثُمَّ انظُرُوا كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ الْمُكْذِبِينَ ﴿١١﴾

13. Pyeti: “E kujt është ajo që gjendet në qiej e në tokë?” Thuaju: “E Allahut!”. Ai ka obliguar mbi Vete mëshirën. Ai patjetër do t’ju tubojë deri në Ditën e Kiametit, në të cilën nuk ka dyshim. Ata që kanë shpjerë veten në humbje, nuk do të besojnë.

14. E Atij është ajo që qëndron në natën e në ditën. Ai është Gjithëdëgjuesi, i Gjithëdijshmi.

15. Thuaju: A të marr dikë tjetër si mik përveç Allahut, që është Krijuesi i qiejve dhe i tokës?! Ai ushqen dhe nuk ushqehet. Thuaju: ‘Jam urdhëruar të bëhem i pari nga kushdo tjetër që iu nënshtrua’. Dhe ti kurrë mos u bëj nga idhujtarët!

16. Thuaj: Njëmend, po e kundërshtova Zotin tim, frikësohem nga ndëshkimi i një dite të madhe.

17. Atë ditë, atij që i largohet (ndëshkimi), do të thotë se Ai e ka mëshiruar atë. Dhe ky është sukcesi i dalluar.

18. Nëse Allahu të sjell ndonjë dëm ty, nuk ka largues të tij përveç Atij dhe, nëse të sjell ndonjë mirësi, Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë.

19. Dhe Ai është i Gjithëfuqishmi mbi robërit e Vet dhe Ai është i Urti, i Gjithinformuari.

قُلْ لِمَنْ مَّا فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ قُلْ لِلَّهِ كَتَبَ عَلَى نَفْسِهِ الرَّحْمَةَ لِيَجْمَعَنَّكُمْ إِلَى يَوْمِ الْقِيَامَةِ لَا رَيْبَ فِيهِ الَّذِينَ خَسِرُوا أَنفُسَهُمْ فَهُمْ لَا يُؤْمِنُونَ ﴿١٣﴾

وَلَهُ مَا سَكَنَ فِي الْآلِ وَالنَّهَارِ وَهُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ ﴿١٤﴾

قُلْ أَعْيَرَ اللَّهُ اتَّخَذُ وَلِيًّا فَاطِرِ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَهُوَ يُطْعَمُ وَلَا يُطْعَمُ قُلْ إِنِّي أُمِرْتُ أَنْ أَكُونَ أَوَّلَ مَنْ أَسْلَمَ وَلَا تَكُونَنَّ مِنَ الْمُشْرِكِينَ ﴿١٥﴾

قُلْ إِنِّي أَخَافُ إِنْ عَصَيْتُ رَبِّي عَذَابَ يَوْمٍ عَظِيمٍ ﴿١٦﴾

مَنْ يُصِرْفَ عَنْهُ يَوْمَئِذٍ فَقَدْ رَحِمَهُ وَذَلِكَ الْفَوْزُ الْمُبِينُ ﴿١٧﴾

وَإِنْ يَمَسُّكَ اللَّهُ بِضُرٍّ فَلَا كَاشِفَ لَهُ إِلَّا هُوَ وَإِنْ يَمَسُّكَ بِخَيْرٍ فَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿١٨﴾

وَهُوَ الْقَاهِرُ فَوْقَ عِبَادِهِ وَهُوَ الْحَكِيمُ الْخَبِيرُ ﴿١٩﴾

20. Pyeti: “Cila është dëshmia më e madhe?” Thuaju: “Allahu është Dëshmitar mes meje dhe jush. Më është shpallur ky Kuran, që me anë të tij t’ju paralajmëroj ju dhe atë që e mbërrin. A vërtet dëshmoni se ka të adhureshëm të tjerë përveç Allahut?” Thuaju: “Unë nuk dëshmoj (një gjë të tillë)” Thuaju: “Me të vërtetë, Ai është i Adhureshmi i Vetëm dhe jam i distancuar nga gjithçka që bëni ortak (me Të)”.

21. Ata të cilëve ua kemi dhënë Librin, e njohin (Librin dhe të Dërguarin) ashtu siç i njohin bijtë e tyre. Ata që e kanë shpjerë veten në humbje, nuk do të besojnë.

22. E kush mund të jetë më keqbërës sesa ai që shpif gënjeshtër mbi Allahun ose i quan gënjeshtër ajetet e Tij?! Sigurisht, keqbërësit nuk gëzojnë sukses.

23. Dhe (kujtojeni) ditën kur do t’i tubojmë të gjithë dhe do t’i pyesim idhujtarët: “Ku janë zotat tuaj që i besonit?”

24. Më pas, nuk do të mbetet dredhia e tyre, përveçse të thonë: “Për Allahun, Zotin tonë! Nuk kemi qenë idhujtarë”.

25. Shiko se si ata gënjejnë kundër vetvetes, dhe atyre u humbet gjithçka që shpifnin.

قُلْ أَيُّ شَيْءٍ أَكْبَرُ شَهَادَةً قُلِ اللَّهُ شَهِيدٌ بَيْنِي وَبَيْنَكُمْ وَأُوحِيَ إِلَيَّ هَذَا الْقُرْآنُ لِأُنذِرَكُمْ بِهِ وَمَنْ بَلَغَ أَتَيْكُمْ لِتَشْهَدُوا أَنْ مَعَ اللَّهِ إِلَهٌ آخَرُ قُلْ لَا أَشْهَدُ قُلْ إِنَّمَا هُوَ إِلَهٌ وَاحِدٌ وَإِنِّي بَرِيءٌ مِمَّا تُشْرِكُونَ ﴿٢٠﴾

الَّذِينَ آتَيْنَاهُمُ الْكِتَابَ يَعْرِفُونَهُ كَمَا يَعْرِفُونَ آبَاءَهُمْ الَّذِينَ خَسِرُوا أَنفُسَهُمْ فَهُمْ لَا يُؤْمِنُونَ ﴿٢١﴾

وَمَنْ أَظْلَمُ مِمَّنِ افْتَرَى عَلَى اللَّهِ كَذِبًا أَوْ كَذَّبَ بِآيَاتِهِ إِنَّهُ لَا يُفْلِحُ الظَّالِمُونَ ﴿٢٢﴾

وَيَوْمَ نَحْشُرُهُمْ جَمِيعًا ثُمَّ نَقُولُ لِلَّذِينَ أَشْرَكُوا آيِنَ شُرَكَائِكُمْ الَّذِينَ كُنْتُمْ تَرْعَمُونَ ﴿٢٣﴾

ثُمَّ لَمْ تَكُنْ فِتْنَتُهُمْ إِلَّا أَنْ قَالُوا وَاللَّهِ رَبِّنَا مَا كُنَّا مُشْرِكِينَ ﴿٢٤﴾

أَنْظُرْ كَيْفَ كَذَبُوا عَلَىٰ أَنفُسِهِمْ وَصَلَّ عَنْهُمْ مَا كَانُوا يَفْتَرُونَ ﴿٢٥﴾

26. Prej tyre ka nga ata, që bëjnë sikur të dëgjojnë ty, kurse Ne kemi vendosur perde mbi zemrat e tyre (dhe nuk mundet) që ata ta kuptojnë, dhe (kemi vënë) një barrë në veshët e tyre. Ata edhe sikur të shohin çdo shenjë, nuk do ta besojnë atë. Kaq shumë (kryeneçë janë), saqë kur vijnë te ti, grinden me ty. Ata që mohuan, thonë: “Këto janë vetëm përralla të të parëve”.

27. Ata edhe (i) ndalojnë (të tjerët) nga ai, edhe vetë rrinë larg prej tij. Ata vetëm vetveten e shkatërrojnë, por nuk ndërgjegjësohen.

28. Sikur t'i shihje kur do të qëndrojnë (pak) para zjarrit, do të thonë: “Ah sikur të ktheheshim, të mos i quanim gënjeshtër shenjat e Zotit tonë dhe të bëheshim ndër besimtarët!”

29. Por e vërteta është që atyre iu zbulua ajo që e fshihnin më parë dhe, edhe sikur të kthehen, do ta përsërisin atë që e kishin të ndaluar. Pa dyshim, ata janë gënjeshtarë.

30. Dhe thonë: “Jeta jonë është vetëm kjo botë dhe nuk do të ringjallemi”.

31. Sikur t'i shihje ata kur do të qëndrojnë para Zotit të tyre, Ai do t'i pyesë: “A nuk është e vërtetë kjo?” Ata do të thonë: “Për Zotin tonë! Patjetër që po”. Ai do t'u thotë: “Atëherë shijoni ndëshkimin për shkak se mohoni!”

وَمِنْهُمْ مَّنْ يَسْتَمِعُ إِلَيْكَ ۗ وَجَعَلْنَا عَلَى قُلُوبِهِمْ أَكِنَّةً أَنْ يَفْقَهُوهُ وَفِي آذَانِهِمْ وَقْرًا ۗ وَإِنْ يَرَوْا كَلِمَةً لَا يُؤْمِنُوهَا حَتَّىٰ إِذَا جَاءُوكَ يُجَادِلُونَكَ يَقُولُ الَّذِينَ كَفَرُوا إِنْ هَذَا إِلَّا أَسَاطِيرُ الْأَوَّلِينَ ﴿٢٦﴾

وَهُمْ يَبْهَوْنَ عَنْهُ وَيَنْوَنَ عَنْهُ ۗ وَإِنْ يُهْلِكُونَ إِلَّا أَنْفُسَهُمْ ۗ وَمَا يَشْعُرُونَ ﴿٢٧﴾

وَلَوْ تَرَىٰ إِذْ وَقَفُوا عَلَى النَّارِ فَقَالُوا يَلَيْتَنَا نُرَدُّ وَلَا نُكَذِّبُ بِآيَاتِ رَبِّنَا وَنَكُونُ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ ﴿٢٨﴾

بَلْ بَدَأَ لَهُمْ مَا كَانُوا يُخْفُونَ مِنْ قَبْلُ ۗ وَلَوْ رُدُّوا لَعَادُوا لِمَا نُهُوا عَنْهُ وَإِنَّهُمْ لَكَاذِبُونَ ﴿٢٩﴾

وَقَالُوا إِنْ هِيَ إِلَّا حَيَاتُنَا الدُّنْيَا وَمَا نَحْنُ بِمَبْعُوثِينَ ﴿٣٠﴾

وَلَوْ تَرَىٰ إِذْ وَقَفُوا عَلَىٰ رَبِّهِمْ ۖ قَالَ أَلَيْسَ هَذَا بِالْحَقِّ ۖ قَالُوا بَلَىٰ وَرَبِّنَا ۖ قَالَ فَذُوقُوا ۖ الْعَذَابَ بِمَا كُنْتُمْ تَكْفُرُونَ ﴿٣١﴾

32. Pa dyshim, humbën ata që mohuan takimin me Allahun, derisa papritmas u erdhi Ora. Thanë: “Vaj për ne për shkujdesjen që kemi bërë rreth saj”. Ata do t'i mbartin barrët e tyre mbi shpinë. Eh sa e keqe është ajo që e mbartin!

33. Jeta e kësaj bote nuk është gjë tjetër, veçse lojë dhe dëfrim. Dhe shtëpia e *ahiretit* është e mirë për ata që kanë drojë (Zotin). A nuk mendoni?!

34. Ne e dimë që ty të brengos ajo që ata thonë. Në të vërtetë, ata ty nuk të quajnë gënjeshtar, por të padrejtët i mohojnë shenjat e Allahut.

35. Edhe para teje janë quajtur gënjeshtarë të Dërguarit dhe ata i duruan përgënjeshttrimet dhe janë sflitur, derisa u erdhi ndihma Jonë. Askush nuk mund t'i ndryshojë fjalët e Allahut. Ty të kanë ardhur lajmet e të Dërguarve.

36. Dhe nëse ty të vjen rëndë shpërfillja e tyre, atëherë po pate fuqi kërko ndonjë tunel në tokë ose shkallë në qiell e sill ndonjë shenjë, (bëje, që ti të bindesh). Sikur të donte Allahu, do t'i bashkonte ata në udhëzim. Prandaj, kurrë mos u bëj ndër të paditurit!

37. Përgjigjen vetëm ata që dëgjojnë. Të vdekurit do t'i ngrejë Allahu dhe tek Ai do të kthehen.

قَدْ حَسِرَ الَّذِينَ كَذَبُوا بِلِقَاءِ اللَّهِ حَتَّىٰ  
إِذَا جَاءَتْهُمْ السَّاعَةُ بَغْتَةً قَالُوا يَحْسِرَتْنَا  
عَلَىٰ مَا فَرَّطْنَا فِيهَا ۗ وَهُمْ يَحْمِلُونَ  
أَوْزَارَهُمْ عَلَىٰ ظُهُورِهِمْ ۗ أَلَا سَاءَ مَا  
يَزُرُونَ ﴿٣٢﴾

وَمَا الْحَيَاةُ الدُّنْيَا إِلَّا لَعِبٌ ۗ وَ لَهُمْ  
وَالَّذَارُ الْآخِرَةُ خَيْرٌ لِلَّذِينَ يَتَّقُونَ ۗ  
أَفَلَا تَعْقِلُونَ ﴿٣٣﴾

قَدْ نَعْلَمُ إِنَّهُ لِيَحِزُّكَ الَّذِي يَقُولُونَ  
فَأِنَّهُمْ لَا يُكَذِّبُونَكَ وَلَكِنَّ الظَّالِمِينَ  
بِآيَاتِ اللَّهِ يَجْحَدُونَ ﴿٣٤﴾

وَلَقَدْ كُذِّبَتْ رُسُلٌ مِنْ قَبْلِكَ فَصَبَرُوا  
عَلَىٰ مَا كُذِّبُوا وَأَوَدُّوا حَتَّىٰ أَنَّهُمْ نَصَرْنَا ۗ  
وَلَا مَبْدَلَ لِكَلِمَاتِ اللَّهِ ۗ وَلَقَدْ جَاءَكَ  
مِنْ نَبِيِّ الْأُمْرُسَلِينَ ﴿٣٥﴾

وَإِنْ كَانَ كَبُرَ عَلَيْكَ إِعْرَاضُهُمْ فَإِنْ  
اسْتَطَعْتَ أَنْ تَبْتَغِيَ نَفَقًا فِي الْأَرْضِ أَوْ  
سُلَّمًا فِي السَّمَاءِ فَتَأْتِيَهُمْ بِآيَةٍ ۗ وَلَوْ شَاءَ  
اللَّهُ لَجَمَعَهُمْ عَلَى الْهُدَىٰ فَلَا تَكُونَنَّ مِنَ  
الْجَاهِلِينَ ﴿٣٦﴾

إِنَّمَا يَسْتَجِيبُ الَّذِينَ يَسْمَعُونَ ۗ وَالْمَوْتَىٰ  
يَعْبَهُمُ اللَّهُ ثُمَّ إِلَيْهِ يُرْجَعُونَ ﴿٣٧﴾



38. Ata thonë: “Përse nuk i është zbritur atij ndonjë shenjë?” Thuaju: Allahu sigurisht që është i Fuqishëm të zbresë ndonjë shenjë. Por shumica prej tyre nuk e dinë.

39. Nuk ka ndonjë gjallesë që ecën në tokë e as shpend që fluturon me dy krahët e tij, të mos jetë si ju në bashkësi. Nuk kemi lënë asgjë mangët në Libër. Në fund, te Zoti i tyre do të tubohen ata.

40. Dhe ata që i quajtën gënjeshtria shenjat Tona janë të shurdhër e memecë, gjenden në errësira. Kë të dojë Allahu e cilëson të devijuar dhe kë të dojë e shpie në rrugë të drejtë.

41. Thuaju: A keni menduar, nëse ju zë ndëshkimi i Allahut ose nëse ju zë ora (e vështirë), a do të lusni tjetërkënd përveç Allahut, nëse jeni të sinqertë?!

42. Përkundrazi, Atë do ta lusin. Atëherë, nëse do të dojë, Ai do t’jua largojë atë për të cilën i luteni dhe ju do ta harroni atë që e bëni ortak (me Të).

43. Sigurisht, u kemi sjellë (të dërguar) shumë popujve përpara teje. Pastaj i vumë në vështirësi dhe skamje, që të përulen.

44. Atëherë, përse ata nuk u përulën kur u erdhi vështirësia prej Nesh, madje zemrat e tyre u ngurtësuan dhe djalli ua zbukuroi veprat që ata bënin.

وَقَالُوا لَوْلَا نُزِّلَ عَلَيْهِ آيَةٌ مِنْ رَبِّهِ  
قُلْ إِنَّ اللَّهَ قَادِرٌ عَلَى أَنْ يُنَزِّلَ آيَةً  
وَلَكِنَّ أَكْثَرَهُمْ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٣٨﴾

وَمَا مِنْ دَابَّةٍ فِي الْأَرْضِ وَلَا طَيْرٍ يَطِيرُ  
بِجَاحِيهِ إِلَّا أُمَّمٌ أَمْثَلُكُمْ مَا فَرَّطْنَا  
فِي الْكِتَابِ مِنْ شَيْءٍ ثُمَّ إِلَىٰ رَبِّهِمْ  
يُحْشَرُونَ ﴿٣٩﴾

وَالَّذِينَ كَذَّبُوا بِآيَاتِنَا صُومُوا بِكُمْ فِي  
الظُّلُمَاتِ مَنْ يَشَاءُ اللَّهُ يُضِلَّهُ وَمَنْ يَشَاءُ  
يَجْعَلْهُ عَلَىٰ صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ ﴿٤٠﴾

قُلْ أَرَأَيْتَكُمْ إِنْ أَتَاكُمْ عَذَابُ اللَّهِ أَوْ  
آتَاكُمْ السَّاعَةَ أَغَيْرَ اللَّهِ تَدْعُونَ إِنْ  
كُنْتُمْ صَادِقِينَ ﴿٤١﴾

بَلْ إِيَّاهُ تَدْعُونَ فَيَكْشِفُ مَا تَدْعُونَ  
عَنِّي وَإِيَّاهُ تَدْعُونَ مَا تَشْرِكُونَ ﴿٤٢﴾

وَلَقَدْ أَرْسَلْنَا إِلَىٰ أُمَمٍ مِنْ قَبْلِكَ فَآخَذْنَاهُمْ  
بِالْبَأْسَاءِ وَالضَّرَّاءِ لَعَلَّهُمْ يَتَضَرَّعُونَ ﴿٤٣﴾

فَلَوْلَا إِذْ جَاءَهُمْ بَأْسُنَا تَضَرَّعُوا وَلَكِنْ  
قَسَتْ قُلُوبُهُمْ وَزَيَّنَ لَهُمُ الشَّيْطَانُ مَا كَانُوا  
يَعْمَلُونَ ﴿٤٤﴾

45. Kur ata e harruan atë që u ishte mësuar, Ne u hapëm dyert e çdo gjëje, derisa ata u mburrën me ato që u ishin dhënë. Atëherë i zumë papritmas dhe ata mbetën të dëshpëruar.

46. Pra, populli që bëri mizori, u pre nga rrënjët. Lavdia është e Allahut, Zotit të botëve.

47. Thuaju: A keni menduar, nëse Allahu ju merr dëgjimin dhe shikimin dhe jua vulos zemrat, cili zot do t'jua kthejë ato, përveç Allahut?! Shiko se si Ne i shpjegojmë shenjat dhe ata sërish largohen.

48. Thuaju: A keni menduar, nëse ndëshkimi i Allahut ju vjen papritmas ose haptas, a do të shkatërrohej ndokush përveç popullit mizor?!

49. Ne dërgojmë të Dërguarit vetëm si sihariqdhënës dhe alarmues. Kushdo që beson dhe e përmirëson veten, nuk do të ketë as frikë e as nuk do të pikëllohet.

50. E ata që i quajtën gënjeshtria shenjat Tona, do t'i zërë ndëshkimi për shkak të ligësive që bënin.

51. Thuaju: Nuk ju them se kam thesaret e Allahut, as nuk di të padukshmen dhe as nuk ju them se jam engjëll. Unë ndjek vetëm atë që më shpallet mua. Thuaju: A mund të barazohet i verbri me atë që sheh?! A nuk mendoheni?!

فَلَمَّا نَسُوا مَا ذُكِّرُوا بِهِ فَتَحْنَا عَلَيْهِمْ  
أَبْوَابَ كُلِّ شَيْءٍ ط حَتَّىٰ إِذَا فَرِحُوا بِمَا أُوتُوا  
أَخَذْنَاهُمْ بَعْتَةً فِإِذَا هُمْ مُبْلِسُونَ ﴿٤٥﴾

فَقَطَّعَ دَائِرَ الْقَوْمِ الَّذِينَ ظَلَمُوا ۗ وَالْحَمْدُ  
لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿٤٦﴾

قُلْ أَرَأَيْتُمْ إِنْ أَخَذَ اللَّهُ سَمْعَكُمْ  
وَأَبْصَارَكُمْ وَخَمَمَ عَلَى قُلُوبِكُمْ مَنْ إِلَهٌ  
غَيْرُ اللَّهِ يَأْتِيكُمْ بِهِ ۗ أَنْظُرْ كَيْفَ  
نُصِرَفَ الْآيَاتِ ۗ ثُمَّ هُمْ يَصْذِقُونَ ﴿٤٧﴾

قُلْ أَرَأَيْتُمْ إِنْ أَنْكُمُ عَذَابُ اللَّهِ  
بَعْتَةً أَوْ جَهْرَةً هَلْ يُهْلِكُ إِلَّا الْقَوْمَ  
الظَّالِمُونَ ﴿٤٨﴾

وَمَا نُرْسِلُ الْمُرْسَلِينَ إِلَّا مُبَشِّرِينَ  
وَمُنذِرِينَ ۗ فَمَنْ أَمَنَ وَاصْلَحَ فَلَا خَوْفٍ  
عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ ﴿٤٩﴾

وَالَّذِينَ كَذَّبُوا بِآيَاتِنَا يَمَسُّهُمُ الْعَذَابُ بِمَا  
كَانُوا يَفْسُقُونَ ﴿٥٠﴾

قُلْ لَا أَقُولُ لَكُمْ عِنْدِي خَزَائِنُ اللَّهِ  
وَلَا أَعْلَمُ الْغَيْبِ وَلَا أَقُولُ لَكُمْ إِنِّي  
مَلَكٌ ۗ إِنَّمَا مَا يُوحَىٰ إِلَيَّ ۗ قُلْ  
هَلْ يَسْتَوِي الْأَعْمَىٰ وَالْبَصِيرُ ۗ أَفَلَا  
تَتَفَكَّرُونَ ﴿٥١﴾

52. Paralajmëroji me anë të këtij (Kurani) ata të cilët frikësohen se do të tubohen para Zotit të tyre, që përveç Atij, ata nuk kanë asnjë mik e asnjë ndërmjetësues, në mënyrë që ata të kenë drujtje.

53. Mos i përzë ata që i luten Allahut duke kërkuar pëlqimin e Tij në mëngjes e në mbrëmje! Nuk të takon ty asgjë nga llogaria e tyre dhe as atyre nuk u takon asgjë nga llogaria jote. Prandaj, nëse do t'i përzësh, do të bëhesh ndër mizorët.

54. Dhe në këtë mënyrë Ne sprovojmë disa me anë të disave të tjerë, që ata të thonë: "A (vetëm) këta i ka favorizuar Allahu mes nesh?!" A nuk i njeh Allahu më së miri mirënjohësit?!

55. Kur të të vijnë ata që besojnë shenjat Tona, thuaju: Paqja qoftë mbi ju! Zoti juaj ia ka caktuar detyrim Vetes mëshirën. (Pra), kushdo nga ju që bën keq nga padija dhe pas kësaj pendohet dhe përmirësohet, atëherë (për të) Ai është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

56. Kështu i shpjegojmë qartë ajetet dhe (kështu bëjmë) me qëllim që të qartësohet rruga e keqbërësve.

57. Thuaju: Mua më është ndaluar t'i adhuroj ata që ju i lusni në vend të Allahut. Thuaju: Unë nuk i ndjek dëshirat tuaja, sepse përndryshe, do të jem i devijuar dhe nuk do të bëhem ndër të udhëzuarit.

وَأَنْذِرْ بِهِ الَّذِينَ يَخَافُونَ أَنْ يُحْشَرُوا إِلَىٰ رَبِّهِمْ لَيْسَ لَهُمْ مِنْ دُونِهِ وَايٌ وَلَا شَفِيعٌ لَّهُمْ يَتَّقُونَ ﴿٥٢﴾

وَلَا تَطْرُدِ الَّذِينَ يَدْعُونَ رَبَّهُمْ بِالْغَدَاةِ وَالْعَشِيِّ يُرِيدُونَ وَجْهَهُ ۗ مَا عَلَيْكَ مِنْ حِسَابِهِمْ مِنْ شَيْءٍ وَوَمَا مِنْ حِسَابِكَ عَلَيْهِمْ مِنْ شَيْءٍ فَتَطْرُدَهُمْ فَتَكُونَ مِنَ الظَّالِمِينَ ﴿٥٣﴾

وَكَذَٰلِكَ فَتَنَّا بَعْضَهُم بِبَعْضٍ لِيَقُولُوا أَهَٰؤَٰلَاءِ مَنَّ اللَّهُ عَلَيْهِمْ مِنْ بَيْنِنَا ۗ أَلَيْسَ اللَّهُ بِأَعْلَمَ بِالشَّاكِرِينَ ﴿٥٤﴾

وَإِذَا جَاءَكَ الَّذِينَ يُؤْمِنُونَ بِآيَاتِنَا فَقُلْ سَلَامٌ عَلَيْكُمْ كَتَبَ رَبُّكُمْ عَلَىٰ نَفْسِهِ الرَّحْمَةَ ۗ أَنَّهُ مَنْ عَمِلَ مِنْكُمْ سُوءًا بِجَهَالَةٍ ثُمَّ تَابَ مِنْ بَعْدِهِ وَأَصْلَحَ فَأَنَّهُ غَفُورٌ رَحِيمٌ ﴿٥٥﴾

وَكَذَٰلِكَ نَفْصَلُ الْآيَاتِ وَلِتَسْتَبِينَ سَبِيلَ الْمُجْرِمِينَ ﴿٥٦﴾

قُلْ إِنِّي نُهَيْتُ أَنْ أَعْبُدَ الَّذِينَ تَدْعُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ ۗ قُلْ لَا أَنبِئُكُمْ بِأَهْوَاءِكُمْ ۗ قَدْ صَلَّيْتُ إِذَا وَمَا أَنَا مِنَ الْمُهْتَدِينَ ﴿٥٧﴾

58. Thuaju: Unë qëndroj mbi një provë të qartë prej Zotit tim kurse ju e keni quajtur gënjeshtër atë. Nuk e kam atë që ju e kërkon shpejt. Vendimi i takon vetëm Allahut. Ai tregon të vërtetën dhe Ai është Gjykuesi më i mirë.

59. Thuaju: Po ta kisha atë që ju e kërkon shpejt, do të ishte e kryer çështja midis meje dhe jush. Allahu i di më së miri keqbërësit.

60. Ai i ka çelësat e së padukshmes, që askush nuk i di përveç Atij. Ai e di atë që është në tokë e në det. Nuk bie asnjë gjethe që Ai nuk e di dhe nuk ka ndonjë farë nëpër errësirat e tokës e as nuk ka asnjë gjë të njomë a të thatë, që nuk është (përmendur) në një libër të qartë.

61. Është Ai që jua merr shpirtin (në gjumë) gjatë natës, duke ditur se çka keni bërë gjatë ditës. Më pas, Ai ju ngre në të (pra, në ditë), që të plotësohet afati (juaj) i caktuar. Pastaj, tek Ai do të ktheheni dhe atëherë Ai do t'ju njoftojë për çdo gjë që bënit.

62. Ai është i Gjithëfuqishmi mbi robërit e Vet. Ai ju dërgon mbrojtës. E kur dikujt nga ju i vjen vdekja, të dërguarit (pra, engjëjt) Tanë ia marrin shpirtin dhe ata nuk anashkalojnë asnjë gjë.

63. Pastaj, ata kthehen tek Allahu, Kujdestari i tyre i Vërtetë. Dëgjoni! Atij i takon vendimi dhe Ai është më i shpejti në llogari.

قُلْ إِنِّي عَلَىٰ بَيِّنَةٍ مِّن رَّبِّي وَكَذَّبْتُمْ بِهِ ۗ<sup>ط</sup>  
مَا عِنْدِي مَا تَسْتَعْجِلُونَ بِهِ ۗ إِنِ الْحُكْمُ  
إِلَّا لِلَّهِ ۗ يَقْضِ الْحَقُّ وَهُوَ خَيْرُ الْفَصْلِينَ ۝٥٨

قُلْ لَوْ أَنَّنِ عِنْدِي مَا تَسْتَعْجِلُونَ بِهِ لَقَضَيْتُ  
الْأَمْرَ بَيْنِي وَبَيْنَكُمْ ۗ وَاللَّهُ أَعْلَمُ  
بِالظَّالِمِينَ ۝٥٩

وَعِنْدَهُ مَفَاتِحُ الْغَيْبِ لَا يَعْلَمَهَا إِلَّا  
هُوَ ۗ وَيَعْلَمُ مَا فِي الْبُرِّ وَالْبَحْرِ ۗ وَمَا  
تَسْقُطُ مِنْ وَرَقَةٍ إِلَّا يَعْلَمُهَا وَلَا حَبَّةٌ  
فِي ظِلْمِ الْأَرْضِ وَلَا رَطْبٌ وَلَا يَأْسٌ  
إِلَّا فِي كِتَابٍ مُّبِينٍ ۝٦٠

وَهُوَ الَّذِي يَتَوَفَّاكُم بِاللَّيْلِ وَيَعْلَمُ مَا  
جَرَحْتُم بِالنَّهَارِ ۗ ثُمَّ يَبْعَثْكُمْ فِيهِ لِيُقْضَىٰ  
أَجَلٌ مُّسَيَّءٌ ۗ ثُمَّ إِلَيْهِ مَرْجِعُكُمْ ثُمَّ  
يُنَبِّئُكُمْ بِمَا كُنتُمْ تَعْمَلُونَ ۝٦١

وَهُوَ الْقَاهِرُ فَوْقَ عِبَادِهِ وَيُرْسِلُ عَلَيْكُمْ  
حَفَظَةً ۗ حَتَّىٰ إِذَا جَاءَ أَحَدَكُمْ الْمَوْتُ  
تَوَفَّاهُ رُسُلُنَا وَهُمْ لَا يُفَرِّطُونَ ۝٦٢

ثُمَّ رُدُّوهُ إِلَى اللَّهِ مَوْلَاهُمُ الْحَقُّ ۗ أَلَا لَهُ  
الْحُكْمُ ۗ وَهُوَ أَسْرَعُ الْحَاسِبِينَ ۝٦٣

64. Pyeti: Kush ju liron nga errësirat e tokës e të detit, kur e lusni Atë me përgjërime dhe fshehurazi: “Nëse na shpëton nga kjo (gjëmë), patjetër do të bëhemi mirënjohës?”

قُلْ مَنْ يُنَجِّيكُمْ مِّنْ ظُلُمَاتِ الْبَرِّ وَالْبَحْرِ تَدْعُونَهُ تَضَرُّعًا وَخُفْيَةً ۗ لَّيْنٌ أُنجِنَا  
مِنْ هَذِهِ لَنَكُونَنَّ مِنَ الشَّاكِرِينَ ﴿٦٤﴾

65. Thuaju: Allahu ju shpëton nga ajo dhe nga çdo shqetësim dhe prapë bëheni idhujtarë.

قُلِ اللَّهُ يُنَجِّيكُمْ مِنْهَا وَمِنْ كُلِّ كَرْبٍ تُمُّ  
أَنْتُمْ تُشْرِكُونَ ﴿٦٥﴾

66. Thuaju: Ai është i Fuqishëm t’ju dërgojë ndëshkim nga sipër jush ose nga poshtë këmbëve tuaja, ose t’ju përçajë në grupe duke ju futur në dyshime dhe t’ju bëjë të shijoni ndëshkimin prej njëri-tjetrit. Shiko, si i shtjellojmë shenjat që ata të mund të kuptojnë.

قُلْ هُوَ الْقَادِرُ عَلَىٰ أَنْ يَبْعَثَ عَلَيْكُمْ  
عَذَابًا مِّنْ فَوْقِكُمْ أَوْ مِنْ تَحْتِ أَرْجُلِكُمْ  
أَوْ يَلْبَسَكُمْ شِيعًا وَيُذِيقَ بَعْضَكُمْ بَأْسَ  
بَعْضٍ ۗ أَنْظُرْ كَيْفَ نَصَّرَفُ الْآيَاتِ لَعَلَّهُمْ  
يَفْقَهُونَ ﴿٦٦﴾

67. Dhe populli yt e ka quajtur gënjeshtër këtë, kurse kjo është e vërteta. Thuaju: Nuk jam përgjegjës mbi ju.

وَكَذَّبَ بِهِ قَوْمُكَ وَهُوَ الْحَقُّ ۗ قُلْ لَسْتُ  
عَلَيْكُمْ بِوَكِيلٍ ﴿٦٧﴾

68. Për çdo profeci ka një kohë dhe vend të caktuar. Së shpejti do ta mësoni.

لِكُلِّ نَبَأٍ مَّسْتَقَرٌّ ۗ وَسَوْفَ تَعْلَمُونَ ﴿٦٨﴾

69. Kur t’i shohësh ata që përqeshin shenjat Tona, largohu prej tyre, derisa ata të merren me ndonjë bisedë tjetër. Dhe nëse të bën djalli të harrosh në këtë çështje, mos qëndro me njerëzit e padrejtë, pasi të të kujtohet.<sup>3</sup>

وَإِذَا رَأَيْتَ الَّذِينَ يَخُوضُونَ فِي آيَاتِنَا  
فَاعْرِضْ عَنْهُمْ حَتَّىٰ يَخُوضُوا فِي حَدِيثٍ  
غَيْرِهِ ۗ وَإِنَّمَا يُنْسِيَنَّكَ الشَّيْطَانُ فَلَا تَقْعُدْ  
بَعْدَ الذِّكْرِ مَعَ الْقَوْمِ الظَّالِمِينَ ﴿٦٩﴾

70. Atyre që kanë drojë ndaj (Zotit) nuk u takon asgjë nga llogaria e tyre

وَمَا عَلَى الَّذِينَ يَتَّقُونَ مِنْ حِسَابِهِمْ مِّنْ

3. Nuk domethënë largimi nga ata përgjithmonë, por do të thotë që sedra fetare duhet t’ju largojë nga ata, për sa kohë që ata vijnë të përqeshin fjalët e Zotit të Madhërisëm.

(e të padrejtëve), por kjo është një këshillë, që (edhe) ata të kenë drojë.

71. Dhe lëri ata që morën fenë si lojë e dëfrim, të cilët i ka mashtruar jeta e kësaj bote dhe këshillo përmes këtij (Kurani), përpara se ndonjë shpirt të shkatërrohet nga ajo që ka bërë. Ai nuk do të ketë asnjë mik e ndërmjetësues përveç Allahut. Edhe sikur të japë çdo shpërblesë, nuk do të pranohet nga ai. Të tillët janë ata që i ka shkatërruar ajo që kanë bërë. Ata do të kenë ujë të valuar për të pirë dhe ndëshkim të dhimbshëm për shkak se mohonin.

72. Pyeti: A t'i lutemi dikujt tjetër përveç Allahut, që as nuk na bën dobi e as nuk na sjell dëm?! Pasi Allahu na ka udhëzuar, a t'u kthehemi gjurmëve tona, si ai të cilin e ka çoroditur djalli, duke e lënë të shtangur në tokë, edhe pse ai ka shokë që e thërrasin drejt udhëzimit: "Eja te ne!""?! Thuaju: Sigurisht, udhëzimi i vërtetë është udhëzimi i Allahut dhe jemi të urdhëruar t'i nënshtrohemi Zotit të botëve.

73. Gjithashtu, (thuaju): Falni namazin dhe kini druajtje ndaj Tij. Është Ai para të cilit do të tuboheni.

74. Dhe është Ai që krijoi qiejt dhe tokën me vërtetësi. Ditën kur ai thotë "Bëhu!", ajo bëhet. Fjala e Tij është e vërtetë. I Atij do të jetë sundimi ditën kur do t'i fryhet bririt. Ai është

سَيُّءٌ وَلَكِنَّ ذِكْرًا لَّهُمْ يَتَّقُونَ ﴿٦٠﴾

وَذَرِ الَّذِينَ اتَّخَذُوا دِينَهُمْ لِبَاطِلٍ وَلَهُوًّا  
وَ غَرَّتْهُمْ الْحَيَاةُ الدُّنْيَا وَذَكَّرَ بِهِ أَنْ  
تُبَسَّلَ نَفْسٌ بِمَا كَسَبَتْ ۗ لَيْسَ لَهَا مِنْ  
دُونِ اللَّهِ وَائِيٍّ وَلَا شَفِيعٍ ۗ وَإِنْ تَعَدِلْ  
كُلَّ عَدِلٍ لَا يُؤَخِّدُ مَهَاتٌ أُولَئِكَ الَّذِينَ  
أَبْسَلُوا بِمَا كَسَبُوا ۗ لَهُمْ شَرَابٌ مِّنْ  
حَمِيمٍ ۗ وَعَذَابٌ أَلِيمٌ بِمَا كَانُوا  
يَكْفُرُونَ ﴿٦١﴾

قُلْ أَدْعُوا مِنْ دُونِ اللَّهِ مَا لَا يَنْفَعُنَا  
وَلَا يَضُرُّنَا وَنُرَدَّ عَلَىٰ أَعْقَابِنَا بَعْدَ إِذْ هَدَيْتَنَا  
اللَّهُ كَالَّذِي اسْتَهْوَتْهُ الشَّيَاطِينُ فِي الْأَرْضِ  
حَيْرَانَ ۗ لَهُ أَصْحَابٌ يَدْعُونَهُ إِلَى الْهُدَىٰ  
أَتَّبِعَا ۗ قُلْ إِنَّ هُدَىٰ اللَّهِ هُوَ الْهُدَىٰ ۗ  
وَأْمَرْنَا لِسُلَيْمَانَ لِرَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿٦٢﴾

وَأَنْ أَقِيمُوا الصَّلَاةَ وَآتُوا الزَّكَاةَ وَهُوَ الَّذِي  
إِلَيْهِ تُحْشَرُونَ ﴿٦٣﴾

وَهُوَ الَّذِي خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ  
بِالْحَقِّ ۗ وَيَوْمَ يَقُولُ كُن فَيَكُونُ ۗ قَوْلُهُ  
الْحَقُّ ۗ وَلَهُ الْمُلْكُ يَوْمَ يُنْفَخُ فِي الصُّورِ ۗ

i Dijshmi i së padukshmes dhe i të dukshmes dhe Ai është i Urti, i Gjithinformuari.

75. Dhe (kujto) kur Ibrahim i tha babait të tij, Azerit: “A ke marrë idhujt për zota?! Unë të shoh ty dhe popullin tënd në humbje të qartë.”

76. Po kështu, i kemi treguar Ibrahimit sundimin e qiejve e të tokës, që ai të bëhet ndër (më) të bindurit.

77. Kur atë e zuri nata, ai pa një yll. Tha: “(Sikur) ky është Zoti im”. E kur ai perëndoi, tha: “Nuk i dua ata që perëdojnë”.<sup>4</sup>

78. Pastaj, kur pa hënën të ndritur, tha: “(Sikur) kjo është Zoti im”. E kur ajo perëndoi, tha: “Nëse Zoti im nuk do të më udhëzonte, pa dyshim do të bëhesha ndër të devijuarit.

79. E kur pa diellin të ndritur, tha: “(Sikur) ky është Zoti im, ky është më i madhi”. E kur ai perëndoi, tha: “O populli im! Jam i çliruar nga ajo që adhuron në vend të Allahut.

عَلَّمَ الْغَيْبِ وَالشَّهَادَةِ وَهُوَ الْحَكِيمُ  
الْخَبِيرُ ﴿٧١﴾

وَإِذْ قَالَ إِبْرَاهِيمُ لِأَبِيهِ أَرَزَّرَ اتَّخَذُ  
أَصْنَامًا إِلَهَةً إِنِّي أَرَاكَ وَقَوْمَكَ فِي  
ضَلَالٍ مُّبِينٍ ﴿٧٢﴾

وَكَذَلِكَ نُرِي إِبْرَاهِيمَ مَلَكُوتَ السَّمَوَاتِ  
وَالْأَرْضِ وَلِيَكُونَ مِنَ الْمُوقِنِينَ ﴿٧٣﴾

فَلَمَّا جَنَّ عَلَيْهِ اللَّيْلُ رَأَى كَوْكَبًا قَالَ هَذَا  
رَبِّي فَلَمَّا أَفَلَ قَالَ لَا أَحِبُّ الْإِفْلِينَ ﴿٧٤﴾

فَلَمَّا رَأَى الْقَمَرَ بَازِعًا قَالَ هَذَا رَبِّي فَلَمَّا  
أَفَلَ قَالَ لَئِن لَّمْ يَهْدِنِي رَبِّي لَأَكُونَنَّ  
مِنَ الْقَوْمِ الضَّالِّينَ ﴿٧٥﴾

فَلَمَّا رَأَى الشَّمْسَ بَازِعَةً قَالَ هَذَا رَبِّي  
هَذَا أَكْبَرُ فَلَمَّا أَفَلَتْ قَالَ يَقَوْمِ إِنِّي  
بَرِيءٌ مِّمَّا تُشْرِكُونَ ﴿٧٦﴾

4. Në ajetet 77-79 është përmendur një debat që ishte zhvilluar midis Hazret Ibrahimit<sup>as</sup> dhe popullit të tij dhe që, në kohë të ndryshme, vijoi deri në tri ditë. Për ta përgënjeshtuar popullin e tij, Hazret Ibrahim i<sup>as</sup> atyre u përmendi yjet dhe tha se ju ato i bëni zota, kurse ato perënduakan. Pastaj tha, disa prej jush hënën e bëjnë zot, ndërsa edhe ajo perëndon. Shumica prej tyre adhuronin diellin, dhe Hazret Ibrahim i<sup>as</sup> tha se dielli edhe pse është më i madhi, edhe ai perëndon, prandaj, adhurimi i një zoti tjetër përveç Allahut është një veprim i gënjeshtërt. Lidhur me këtë ajet, disa komentues bashkëkohës tregojnë lloj-lloj përrallash, duke thënë se Hazret Ibrahim i<sup>as</sup> e kishte burgosur babai i tij dhe kur doli prej burgut, gjoja për herë të parë kishte parë një yll, pastaj hënën, pastaj edhe diellin dhe për herë të parë kishte marrë vesh se ato të gjitha perëdojnë. Një komentim i tillë nuk është i saktë.

80. Sigurisht, i kam përkushtuar vëmendjen time Atij që krijoi qiejt dhe tokën, duke qenë i nënshtruar (ndaj Tij), dhe nuk jam nga idhujtarët.

إِنِّي وَجَّهْتُ وَجْهِيَ لِلذِّينِ فَطَرَ السَّمَوَاتِ  
وَالْأَرْضِ حَيْفًا وَمَا أَنَا مِنَ الْمُشْرِكِينَ ﴿٨٠﴾

81. Populli i tij u grind me të. Ai tha: “A po grindeni me mua në lidhje me Allahun, ndërsa Ai më ka udhëzuar?! Nuk frikësohem nga ata që adhuroni në vend të Tij, (unë nuk dua asgjë) përveç asaj që do Zoti im. Zoti im përfshin gjithçka me dije. A nuk mendoheni?!”

وَحَاجَّهُ قَوْمُهُ ۖ قَالَ اتَّخَذُوا فِي اللَّهِ  
وَقَدْ هَدَانِ ۗ وَلَا أَخَافُ مَا تُشْرِكُونَ بِهِ إِلَّا  
أَنْ يَشَاءَ رَبِّي شَيْئًا ۗ وَسِعَ رَبِّي كُلَّ شَيْءٍ  
عِلْمًا ۗ أَفَلَا تَتَذَكَّرُونَ ﴿٨١﴾

82. E si mund të frikësohem nga ata që i bëni ortakë (Allahut), kurse ju nuk frikësoheni duke i bërë ortak Allahut, gjë për të cilën Ai nuk ju ka zbritur ndonjë argument?! Pra, cila nga dy palët meriton paqen më shumë? (Tregomëni) nëse e dini!”

وَكَيْفَ أَخَافُ مَا أَشْرَكْتُمْ وَلَا تَخَافُونَ  
أَنكُمْ أَشْرَكْتُمْ بِاللَّهِ مَا لَمْ يُنَزَّلْ بِهِ  
عَلَيْكُمْ سُلْطَانًا ۗ فَأَيُّ الْفَرِيقَيْنِ أَحَقُّ  
بِالْأَمْنِ ۗ إِنَّ كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ ﴿٨٢﴾

83. Ata që besuan dhe nuk e kanë përzier besimin e tyre me padrejtësi, do të kenë paqe dhe do të jenë të udhëzuar.

الَّذِينَ آمَنُوا وَلَمْ يَلْبِسُوا إِيمَانَهُمْ بِظُلْمٍ  
أُولَئِكَ لَهُمُ الْأَمْنُ وَهُمْ مُهْتَدُونَ ﴿٨٣﴾

84. Ky ishte argumenti Ynë që ia dhamë Ibrahimit kundër popullit të tij. Ne ngremë në pozitë kë të duam. Sigurisht, Zoti yt është i Urtë, i Gjithëdijshëm.

وَتِلْكَ حُجَّتُنَا آتَيْنَاهَا إِبْرَاهِيمَ عَلَى  
قَوْمِهِ ۗ لِرَفْعِ دَرَجَاتٍ مِّنْ نَّشَاءٍ ۗ إِنَّ رَبَّكَ  
حَكِيمٌ عَلِيمٌ ﴿٨٤﴾

85. (Ibrahimit) i dhuruam Is'hakun dhe Jakubin. Të gjithë i udhëzuam. Më parë Nuhun e udhëzuam. Edhe nga pasardhësit e tij: Davudin, Sulejmanin, Ejubin, Jusufin,

وَوَهَبْنَا لَهُ إِسْحَاقَ وَيَعْقُوبَ ۗ كُلًّا هَدَيْنَا  
وَنُوحًا هَدَيْنَا مِنْ قَبْلُ ۗ وَمِنْ ذُرِّيَّتِهِ دَاوُدَ  
وَسُلَيْمَانَ وَيُوسُفَ وَمُوسَىٰ وَ



Musain dhe Harunin. Ne kështu i shpërblejmë mirëbërësit.<sup>5</sup>

هُرُونَ وَكَذَلِكَ نَجْزِي الْمُحْسِنِينَ ﴿٥٥﴾

86. Po ashtu, (edhe) Zekerijanë, Jahjain, Isain dhe Ijasin. Të gjithë këta kanë qenë ndër të dëlirët.

وَزَكَرِيَّا وَيَحْيَىٰ وَعِيسَىٰ وَإِلْيَاسَ كُلٌّ مِّنَ الصَّالِحِينَ ﴿٥٦﴾

87. Dhe Ismailin, Eljesanë, Junusin dhe Lutin. Të gjithë këtyre u kemi dhënë epërsi mbi botët.<sup>6</sup>

وَإِسْمَاعِيلَ وَإِسْحَاقَ وَيُوسُفَ وَهُدَّادَ وَكَوْنَانَ فَضَلْنَا عَلَى الْعَالَمِينَ ﴿٥٧﴾

5. Ejubi ose Jobi është personazhi kryesor i Librit të Jobit në Bibël, sipas së cilës, ai jetoi në tokën e Uzit. Disa autoritete thonë se kjo është Idumea ose Arabia Deserta, kurse disa të tjerë e shohin Mesopotaminë si vendlindjen e tij. Duket se Uz ishte diku në veri të Arabisë. Thuhet se Jobi ka jetuar atje përpara largimit të izraelitëve nga Egjipti. Kështu ai jetoi para Moisiut ose, siç thonë disa, ishte bashkatdhetar i Moisiut, pasi kishte marrë misionin e tij profetik rreth 20 vjet para tij. Ai nuk ishte izraelit, ngaqë kishte prejardhje nga Esau, vëllai i madh i Izraelit. Ai pati një jetë të vrullshme, të mbushur me sprova nga më të ndryshmet, por u tregua jashtëzakonisht besnik ndaj pëlqimit të Zotit, i drejtë dhe shumë i durueshëm edhe në fatkeqësitë ekstreme (Jewish Enc. & Enc. of Islam). Për të Zoti thotë në Kuran: “Pa dyshim, Ne e gjetëm (Ejubin) të duruar. Sa rob i mirë që ishte ai! Ishte shumë i përlur.” (38:45).

6. Në këtë dhe në dy ajete të mëparshme, Profetët që vijnë nga Nuhu<sup>as</sup> janë ndarë në tri grupe të ndryshme dhe secilin grup Zoti i Madhërishtëm e lavdëroi me një cilësi dalluese. Grupi i parë përfshin Davudin<sup>as</sup>, Sulejmanin<sup>as</sup>, Ejubin<sup>as</sup>, Jusufin<sup>as</sup>, Musain<sup>as</sup> dhe Harunin<sup>as</sup>. Këtyre Profetëve Allahu u dha fuqi e prosperitet dhe si rrjedhojë ishin në gjendje të punonin edhe për mirëqenien e popujve ku jetuan. Prandaj, vërehet se ky grup Profetësh janë quajtur *mirëbërës*, sepse, nëpërmjet sundimit dhe prosperitetit të tyre të përkohshëm, ata arritën t’u bënin mirësi të shumta popujve përkatës. Davudi dhe Sulejmani ishin mbretër; Jusufi dhe Ejubi u bekuan me begati pasi kaluan sprova të mundimshme me durim shembullor. Musai dhe Haruni gëzonin autoritetin suprem mbi popullin e tyre. Në grupin e dytë të Profetëve që janë përmendur në këto ajete përmenden Zekerija<sup>as</sup>, Jahja<sup>as</sup> (Gjoni), Isai<sup>as</sup> dhe Elija<sup>as</sup>. Asnjë prej tyre nuk posedoi sundim ose begati materiale; secili bëri një jetë të përlur dhe të thjeshtë. Profetët e këtij grupi janë përshkruar si *të dëlirë*. Grupi i tretë i përmendur në këto ajete përbëhet nga Ismaili<sup>as</sup>, Eljesa<sup>as</sup> (Eliseu), Junusi<sup>as</sup> dhe Luti<sup>as</sup>. Edhe ata nuk zotëronin sundimin dhe pushtetin tokësor, por Zoti u dha hir dhe përsosmëri. Në popujt e mëparshëm, secili prej tyre u akuzua për lakminë dhe pandershmërinë. Për Ismailin, lexojmë në Bibël: “ai do të jetë ndërmjet njerëzve si një gomar i egër; dora e tij do të jetë kundër të gjithëve dhe dora e të gjithëve kundër tij” (Zanafilla 16:12). Për Eliseun thuhet se ai bëri që të vritej një mbret, të cilit nuk iu bind, në mënyrë që të fitonte pushtetin. Jonai (Junusi) supozohet të ishte i pakënaqur me Zotin, pasi mendonte se u turpërua nga mospërbushja e profecisë së tij, e cila, siç pretendohet, tregoi se ai kërkonte pushtetin për veten e tij. Për Lotin (Luti) thuhet se ai lakmonte tokat pjellore të kullotave dhe zihet gjithnjë me të afërmin e tij, Abrahamin. Kështu të gjithë këta Profetë janë akuzuar se lakmonin pasurinë dhe pushtetin. Por Kurani i shpall të pafajshëm nga të gjitha akuzat dhe pohon se te Zoti ata gëzonin lartësi shpirtërore.

88. Edhe nga etërit e tyre, nga pasardhësit e tyre dhe vëllezërit e tyre (disave u kemi dhënë epërsi). I zgjodhëm dhe i udhëzuar në rrugë të drejtë.

89. Ky është udhëzimi i Allahut. Me anë të tij, Ai udhëzon kë të dojë nga robërit e Vet. Sikur ata të adhuronin dikë tjetër, do t'u dështonte gjithçka që bënin.

90. Këta ishin ata, të cilëve u dhamë Librin, urtësinë dhe profetërinë. Pra, nëse këta do ta mohojnë këtë, Ne do t'ia dorëzojmë një popull, që nuk do ta mohojnë.

91. Këta janë ata, që i udhëzoi Allahu. Ndaj, ndiqe udhëzimin e tyre (që Allahu ua kishte dhënë). Thuaju: Nuk ju kërkoj ndonjë shpërblim për këtë. Kjo është vetëm një këshillë për botët.

92. Ata nuk e vlerësuan Allahun ashtu siç duhej vlerësuar Ai, kur thanë: "Allahu nuk zbriti asgjë mbi njeri". Pyeti: Kush e zbriti Librin që kishte sjellë Musai si dritë dhe udhëzim për njerëzit, të cilin e keni bërë copa letre (dhe të cilin) pak e shfaqni dhe shumicën e fshihni?! Ndonëse, juve ju është mësuar ajo që nuk e dinit ju dhe as etërit tuaj. Thuaju: Allahu (e zbriti atë). Pastaj, lëri ata të luajnë në kotësinë e tyre.

93. Dhe ky Libër që kemi zbritur është i bekuar, vërtetues i asaj që ai

وَمِنْ آبَائِهِمْ وَذُرِّيَّاتِهِمْ وَإِخْوَانِهِمْ  
وَأَجْنَبِيِّنَّهُمْ وَهَدَيْنَاهُمْ إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ ﴿٨٨﴾

ذَلِكَ هُدَى اللَّهِ يَهْدِي بِهِ مَنْ يَشَاءُ مِنْ  
عِبَادِهِ ۗ وَلَوْ أَشْرَكُوا لَحِطَّ عَلَيْهِمْ مَا كَانُوا  
يَعْمَلُونَ ﴿٨٩﴾

أُولَئِكَ الَّذِينَ آتَيْنَاهُمُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَ  
وَالنَّبُوَّةَ ۗ فَإِنْ يَكْفُرْ بِهَا هَؤُلَاءِ فَقَدْ وَكَلْنَا  
بِهَا قَوْمًا لَيَكْفُرُنَّ بِهَا بِكُفْرِنٍ ﴿٩٠﴾

أُولَئِكَ الَّذِينَ هَدَى اللَّهُ فَبِهِدَاهُمُ افْتَدَاهُ  
قُلْ لَا أَسْأَلُكُمْ عَلَيْهِ أَجْرًا ۗ إِنْ هُوَ إِلَّا  
بِحُجْرِي لِلْعَالَمِينَ ﴿٩١﴾

وَمَا قَدَرُوا اللَّهَ حَقَّ قَدْرِهِ إِذْ قَالُوا مَا  
أَنْزَلَ اللَّهُ عَلَى بَشَرٍ مِنْ شَيْءٍ ۗ قُلْ مَنْ  
أَنْزَلَ الْكِتَابَ الَّذِي جَاءَ بِهِ مُوسَى نُورًا  
وَ هُدًى لِلنَّاسِ تَجْعَلُونَهُ قَرَاطِيسَ  
تَبَدُّونَهَا وَيُخْفُونَ كَثِيرًا ۗ وَعَلَّمْتُمْ مَا لَمْ  
تَعْلَمُوا أَنْتُمْ وَلَا آبَاؤُكُمْ ۗ قُلِ اللَّهُ لَمْ  
ذَرَّهُمْ فِي خَوَاصِهِمْ يَلْعَبُونَ ﴿٩٢﴾

وَهَذَا كِتَابٌ أَنْزَلْنَاهُ مُبْرَكٌ مُصَدِّقٌ

ka përpara, që ti të alarmosh nënën e vendbanimeve, si dhe ata që banojnë rreth saj.<sup>7</sup> Ata që besojnë në *ahiret*, e besojnë edhe këtë (Libër) dhe ata e ruajnë namazin e tyre.

94. E kush mund të jetë më keqbërës se ai që shpif gënjeshtër mbi Allahun ose thotë – Më është shpallur – ndërkohë asgjë nuk i është shpallur atij dhe ai që thotë – Do të sjell (fjalë) të ngjashme që ka zbritur Allahu?! Sikur t'i shihje keqbërësit në agoninë e vdekjes, kur engjëjt zgjasin duart drejt tyre (duke thënë): “Dorëzohini shpirtat tuaj! Sot do të dënoheni me ndëshkim poshtërues për atë që thoshit për Allahun në mënyrë të padrejtë dhe se tregoheshit mendjemëdhenj ndaj shenjave të Tij!”

95. Ja, na erdhët veç e veç, ashtu siç ju kishim krijuar për herë të parë, dhe e latë pas atë që ju kishim begatuar! E pse nuk po i shohim me ju ndërmjetësuesit tuaj, të cilët ju i kujtonit se janë ortakë (me Allahun) në dobinë tuaj?! Ja, tashmë jeni ndarë dhe ata që i kujtonit (si ortakë) i keni humbur.

96. Allahu i shpërthen farat dhe bërthamat. Ai nxjerr të gjallin nga i vdekuri dhe nxjerr të vdekurin nga i

الَّذِي بَيْنَ يَدَيْهِ وَيُنذِرَ أُمَّ الْقُرَىٰ  
وَمَنْ حَوْلَهَا وَالَّذِينَ يُؤْمِنُونَ بِالْآخِرَةِ  
يُؤْمِنُونَ بِهِ وَهُمْ عَلَىٰ صَلَاتِهِمْ  
يُحَافِظُونَ ﴿١٧﴾

وَمَنْ أَظْلَمُ مِمَّنِ افْتَرَىٰ عَلَى اللَّهِ كَذِبًا  
أَوْ قَالَ أُوحِيَ إِلَيَّ وَلَمْ يُوحَ إِلَيْهِ شَيْءٌ  
وَمَنْ قَالَ سَأُنزِلُ مِثْلَ مَا أَنْزَلَ اللَّهُ  
وَلَوْ تَرَىٰ إِذِ الظَّالِمُونَ فِي غَمَرَاتِ الْمَوْتِ  
وَالْمَلَائِكَةُ بَاسِطَوْنَ أَيْدِيَهُمْ ۗ خَرَجُوا  
أَنْفُسَهُمْ ۗ أَلْيَوْمَ تُجْرَوْنَ عَذَابَ الْهُونِ  
بِمَا كُنتُمْ تَقُولُونَ عَلَى اللَّهِ غَيْرَ الْحَقِّ  
وَكُنتُمْ عَنْ آيَاتِهِ تَسْتَكْبِرُونَ ﴿١٨﴾

وَلَقَدْ جِئْتُمُونَا فُرَادَىٰ كَمَا خَلَقْتُمْ  
أَوَّلَ مَرَّةٍ وَتَرَكْتُمْ مَا خَوَّلْتُمْ وَرَاءَ  
ظُهُورِكُمْ ۗ وَمَا نَرَىٰ مَعَكُمْ شُفَعَاءَكُمُ  
الَّذِينَ زَعَمْتُمْ أَنَّهُمْ فِيكُمْ شُرَكَاءُ ۗ لَقَدْ  
تَقَطَّعَ بَيْنَكُمْ وَضَلَّ عَنْكُمْ مَا كُنتُمْ  
تَزْعُمُونَ ﴿١٩﴾

إِنَّ اللَّهَ فَالِقُ الْحَبِّ وَالنَّوَىٰ ۗ يُخْرِجُ  
الْحَيَّ مِنَ الْمَيِّتِ وَمُخْرِجُ الْمَيِّتِ مِنَ

7. Ky ajet ndër të tjera tregon edhe vlerat e gjuhës arabe dhe se ajo është gjuhë mëmë, Kurani është esencë e të gjithë Librave të mëparshëm dhe Meka është ama e gjithë tokës.

gjalli. Ky është Allahu juaj. E ju, ku përhumbeni?!<sup>8</sup>

الْحَيُّ ذِكْمُ اللَّهِ فَالَى تُوَفَّكُونَ ﴿١٠﴾

97. Ai i shpërthen agimet. Ai bëri natën për qetësi, ndërsa diellin dhe hënën për njehsim. Ky është caktimi nga Mbizotëruesi, i Gjithëdijshmi.

فَالِقُ الْإِصْبَاحِ وَجَعَلَ اللَّيْلَ سَكَنًا  
وَالشَّمْسَ وَالْقَمَرَ حُسْبَانًا ذَلِك تَقْدِيرُ  
الْعَزِيزِ الْعَلِيمِ ﴿١٧﴾

98. Dhe është Ai që bëri yjet për ju, që të udhëzoheni me anë të tyre në errësirat e tokës e të detit. Ne i kemi shpjeguar qartë shenjat për njerëzit që dinë.

وَهُوَ الَّذِي جَعَلَ لَكُمْ النُّجُومَ لِتَهْتَدُوا  
بِهَا فِي ظُلُمَاتِ الْبَرِّ وَالْبَحْرِ قَدْ فَصَّلْنَا  
الآيَاتِ لِقَوْمٍ يَعْلَمُونَ ﴿١٧﴾

99. Dhe është Ai që ju krijoi nga një shpirt i vetëm dhe (bëri për ju) vendstrehim dhe vendbanim. Ne i kemi shpjeguar qartë shenjat për njerëzit që kuptojnë.

وَهُوَ الَّذِي أَنْشَأَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ  
فَمُسْتَقَرًّا وَمُسْتَوْدَعًا قَدْ فَصَّلْنَا الْآيَاتِ  
لِقَوْمٍ يَفْقَهُونَ ﴿١٧﴾

100. Dhe është Ai që prej qiellit zbriti ujë. Pastaj, nga ai kemi nxjerrë çdolloj bimësie dhe prej saj kemi nxjerrë një gjelbërim, prej të cilit nxjerrim fara të mbështjella. Po ashtu, edhe nga palma hurmash, nga vilet e tyre, (nxjerrim) fruta të ngarkuara e të varura, si dhe kopshte rrushi, ulliri dhe shege, të ngjashme dhe jo të ngjashme. Vëzhgoni frutat e tyre kur bëhen fruta, dhe (vëzhgoni) pjekjen e tyre. Sigurisht, në të ka shenja për njerëzit që besojnë.

وَهُوَ الَّذِي أَنْزَلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً  
فَأَخْرَجْنَا بِهِ نَبَاتَ كُلِّ شَيْءٍ فَأَخْرَجْنَا مِنْهُ  
خَضِرًا نُخْرَجُ مِنْهُ حَبًّا مُتَرَاكِبًا وَمِنَ  
النَّخْلِ مِنَ طَلْعِهَا قَنَاطٍ دَانِيَةٌ وَجَنَّتِ  
مِنَ أَعْنَابٍ وَالزَّيْتُونَ وَالرَّيْحَانُ مُمْتَثِلِينَ  
وَعَيْرَ مُتَشَابِهٍ أَنْظَرُوا إِلَى ثَمَرِهِ إِذَا أَثْمَرَ  
وَيَنْعِهِ إِنَّ فِي ذَلِكُمْ لآيَاتٍ لِقَوْمٍ  
يُؤْمِنُونَ ﴿١٧﴾

8. Ajeti na tërheq vëmendjen te fara, prej së cilës mbin një bimë dhe bëhet pemë e madhe, edhe pse në fazën e parë ajo mund të duket krejt e parëndësishme. Në mënyrë të ngjashme, porsi fara, njeriu është i aftë të rritet, të përparojë aq sa të arrijë të marrë zbulesën Hyjnore dhe të pasqyrojë atributet e Zotit.

101. Ata bënë xhindët ortakë të Allahut, kurse Ai i ka krijuar ata, dhe sajojnë pa kurrfarë dije bijë e bija për Të. I Pastër është Ai dhe i lartë nga ajo që përshkruajnë ata.

وَجَعَلُوا لِلَّهِ شُرَكَاءَ الْجِنَّ وَخَلَقَهُمْ  
وَحَرَاقُوا لَهُ بَيْنَ وَبَيْنَ بِغَيْرِ عِلْمٍ<sup>ط</sup>  
سُبْحٰنَهُ وَتَعَالٰى عَمَّا يَصِفُوْنَ<sup>١٧</sup>

102. Ai është Krijuesi nga asgjëja i qiejve dhe i tokës. Si mund të ketë ai fëmijë, ndërkohë Ai nuk ka grua?! Ai krijoi çdo gjë. Ai është i Gjithëdijshëm për çdo gjë.

بَدِيعُ السَّمٰوٰتِ وَالْاَرْضِ اَلَيْ يَكُوْنُ لَهُ  
وَلَدٌ وَّلَمْ تَكُنْ لَهُ صٰحِبَةٌ وَّخَلَقَ كُلَّ  
شَيْءٍ وَّهُوَ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيْمٌ<sup>١٨</sup>

103. Ky është Allahu, Zoti juaj. Nuk ka të adhurueshëm tjetër përveç Tij. Krijuesi i çdo gjëje. Ndaj, Atë adhurojeni. Ai është Mbikëqyrësi i çdo gjëje.

ذِكْرُكَ اللّٰهَ رَبِّكُمْ لَا اِلٰهَ اِلَّا هُوَ خَالِقُ  
كُلِّ شَيْءٍ فَاَعْبُدُوْهُ وَّهُوَ عَلٰى كُلِّ شَيْءٍ  
وَكَیْلٌ<sup>١٩</sup>

104. Sytë nuk e arrijnë Atë, por Ai i arrin sytë. Ai është i Mprehti, i Gjithinformuari.<sup>9</sup>

لَا تُدْرِكُهُ الْاَبْصَارُ وَّهُوَ يَدْرِكُ الْاَبْصَارَ  
وَّهُوَ اللّٰطِيْفُ الْخَبِيْرٌ<sup>٢٠</sup>

105. Juve ju kanë ardhur dritësime prej Zotit tuaj. Ai që dritësohet, e bën për veten e tij dhe ai që verbohët, e bën kundër vetes së tij, dhe unë nuk jam rojtar mbi ju.

قَدْ جَاءَكُمْ بَصٰیْرٌ مِّنْ رَبِّكُمْ فَمَنْ  
اَبْصَرَ فَلِنَفْسِهِ وَّمَنْ عَمِيَ فَعَلَيْهَا وَمَا اَنَا  
عَلَيْكُمْ بِحٰفِيْظٍ<sup>٢١</sup>

9. Dy atributet Hyjnore i Mprehti ose i Paformi (El-Latif) dhe i Gjithinformuari (El-Khabir) japin në mënyrën më të bukur arsyen e dy pohimeve të bëra në pjesën e parë të ajetit. Pohimi i parë është se sytë nuk mund ta arrijnë Atë. Arsyeya është se Ai është i Paformi, dhe duke qenë i tillë, Ai nuk mund të kuptohet vetëm nga arsyeya njerëzore. Nëpërmjet arsyes, njeriu mund të arrijë vetëm deri te bindja se duhet të ketë një Zot. Pohimi i dytë është se Ai arrin te sytë. Arsyeya është se Ai është i Gjithëdijshmi, dhe duke qenë i tillë, Ai e di se njerëzimi ka nevojë për ta njohur Atë, andaj, Ai arrin te ta me mesazhet e Tij. Përveç kësaj, atributi i Gjithinformuar gjithashtu tregon se Ai është në dijeni se cili prej njerëzve ka etje të sinqertë për ta "parë" Zotin, dhe pikërisht atij Ai i tregon manifestime të Tij. Shkurt, askush nuk ka fuqi ta shohë vetë me sytë e zemrës Zotin e Madhërishëm. Është Zoti Ai që u shfaqet robërve të Tij të sinqertë. Kjo ndodh edhe në botën lëndore. Njerëzit, në përgjithësi, mendojnë se shikimi buron nga sytë dhe shkon tek objekti, kurse në të vërtetë, është drita ajo që mbërrin te sytë.

106. Kështu Ne i shtjellojmë ajetet, që ata të thonë – (Na) e ke mësuar – dhe që t'ua bëjmë të qartë këtë njerëzve që dinë.

107. Ndiqe atë që të është shpallur ty prej Zotit tënd! Nuk ka të adhurueshëm tjetër përveç Tij. Shmangu prej idhujtarëve!

108. Po të donte Allahu, ata nuk do të adhuronin tjetërkënd përveç Tij. Ne nuk të kemi caktuar rojtar mbi ta dhe ti as nuk je mbikëqyrësi i tyre.

109. Mos i shani (idhujt), të cilëve ata u luten në vend të Allahut, përndryshe, edhe ata do ta shajnë Allahun armiqësisht, me padije. Kështu ia zbukuroam çdo populli veprat e tij.<sup>10</sup> Më pas, kthimi i tyre është te Zoti i tyre. Ndaj, Ai do t'ua tregojë atë që bënin.<sup>11</sup>

110. Ata bëjnë betime të forta për Allahun, që nëse do t'u vijë ndonjë shenjë, do ta besojnë patjetër. Thuaju se shenjat janë tek Allahu dhe çfarë mund t'ju bindë se kur ato u vijnë, ata nuk besojnë!

وَكَذَلِكَ نُنصِّفُ الْآيَاتِ وَلِيَقُولُوا دَرَسْتَ  
وَلِنُبَيِّنَهُ لِقَوْمٍ يَعْلَمُونَ ﴿١٠﴾

اتَّبِعْ مَا أُوحِيَ إِلَيْكَ مِنْ رَبِّكَ ۚ لَا إِلَهَ إِلَّا  
هُوَ ۚ وَاعْرِضْ عَنِ الْمُشْرِكِينَ ﴿١١﴾

وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ مَا أَشْرَكُوا ۗ وَمَا جَعَلْنَاكَ  
عَلَيْهِمْ حَفِيظًا ۗ وَمَا أَنْتَ عَلَيْهِمْ بِوَكِيلٍ ﴿١٢﴾

وَلَا تَسُبُّوا الَّذِينَ يَدْعُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ  
فَيَسُبُّوا اللَّهَ عَدْوًا بِغَيْرِ عِلْمٍ ۗ كَذَلِكَ زَيَّنَّا  
لِكُلِّ أُمَّةٍ عَمَلَهُمْ ۖ ثُمَّ إِلَىٰ رَبِّهِمْ مَرْجِعُهُمْ  
فَيُنَبِّئُهُمْ بِمَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿١٣﴾

وَأَقْسَمُوا بِاللَّهِ جَهْدَ أَيْمَانِهِمْ لَئِنْ  
جَاءَتْهُمْ آيَةٌ لَيُؤْمِنُنَّ بِهَا ۗ قُلِ إِنَّمَا الْآيَاتُ  
عِنْدَ اللَّهِ ۚ وَمَا يُشْعِرُكُمْ أَنَّهَا إِذَا جَاءَتْ  
لَا يُؤْمِنُونَ ﴿١٤﴾

10. Fjala “zbukuroam” nuk do të thotë se Vetë Zoti bën që veprimet e liga të njeriut t'i duken të drejta, por do të thotë vetëm se Zoti e ka krijuar në mënyrë të tillë natyrën njerëzore që kur njeriu këmbëngul në kryerjen e një veprimi të caktuar, ai fiton një dëshirë për të dhe veprimi i tij fillon t'i duket i bukur në sytë e tij. Në fakt, në këtë ligj të Zotit qëndron edhe sekreti i përparimit të gjithanshëm të njeriut, të atij që e përdor në mënyrë të drejtë. Kështu që, në përputhje me këtë ligj të përgjithshëm, edhe idhujtarëve që këmbëngulin në idhujtari, fillon t'u pëlqejë adhurimi i idhujve.

11. Sipas mësimëve të Kuranit të Shenjtë, idhujt pavarësisht se nuk gëzojnë asnjë pozitë shpirtërore, Zoti e edukon muslimanin të frenojë gjuhën, të mos i shajë idhujt dhe të këshillojë me butësi idhujtarët, sepse mundet që edhe idhujtarët të nxehen dhe të fillojnë të shajnë Zotin dhe në këtë rast, do të ishte muslimani shkak i gjuhës së lig të idhujtarëve.

111. Ne ua turbullojmë zemrat dhe shikimet, ashtu siç ata nuk e besuan herën e parë (të Dërguarin) dhe i lëmë të vërtiten në tërbimin e tyre.

وَنُقَلِّبُ أَفْئِدَتَهُمْ وَ أَبْصَارَهُمْ كَمَا لَمْ يُؤْمِنُوا بِهِ أَوَّلَ مَرَّةٍ وَ نَذَرُهُمْ فِي طَعْيَانِهِمْ يَعْمَهُونَ ﴿١١١﴾

Xhuzi 8

112. Dhe sikur atyre t'u zbrisnim engjëjt, t'u flisnin të vdekurit e Ne të grumbullonim çdo gjë përpara tyre, ata nuk do të ishin të tillë që besojnë, përveçse nëse Allahu do të donte. Por, shumica e tyre janë të paditur.

وَ لَوْ أَنَّا نَزَّلْنَا إِلَيْهِمُ الْمَلَائِكَةَ وَ كَلَّمَهُمُ الْمَوْتَى وَ حَشَرْنَا عَلَيْهِمْ كُلَّ شَيْءٍ قُبُلًا مَا كَانُوا لِيُؤْمِنُوا إِلَّا أَنْ يَشَاءَ اللَّهُ وَ لَكِنَّ أَكْثَرَهُمْ يَجْهَلُونَ ﴿١١٢﴾

113. Dhe kështu, çdo profeti ia kemi bërë armiq djajtë prej njerëzve e xhindëve. Ata njëri-tjetrit i shpallin fjalë të bukura me mashtrim. Po të donte Zoti yt, ata nuk do ta bënë këtë, andaj, lëri ata dhe trillimet e tyre;<sup>12</sup>

وَ كَذَلِكَ جَعَلْنَا لِكُلِّ نَبِيٍّ عَدُوًّا شَيْطِينِ الْإِنْسِ وَ الْجِنِّ يُوحِي بَعْضُهُمْ إِلَى بَعْضٍ زُخْرُفَ الْقَوْلِ غُرُورًا ۗ وَ لَوْ شَاءَ رَبُّكَ مَا فَعَلُوهُ فَذَرُهُمْ وَ مَا يَفْتَرُونَ ﴿١١٣﴾

114. që zemrat e atyre të cilët nuk e besojnë *ahiretin*, të priren nga ky (mashtrim), që ata të kënaqen me të dhe të vijnë t'i bëjnë (të këqijat) ashtu siç janë duke i bërë.

وَ لَتَصْغَىٰ إِلَيْهِ أَفِئدَةُ الَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ بِالْآخِرَةِ وَ لَيَرْضَوهُ وَ لَيَقْتِرِفُوا مَا هُمْ مُّقْتَرِفُونَ ﴿١١٤﴾

115. A të preferoj dikë tjetër si gjykatës, përveç Allahut, edhe pse është Ai që jua zbriti Librin të hollësishëm?! E ata që ua kemi dhënë Librin, e dinë se ai është zbritur me të vërtetën prej Zotit tënd, andaj kurrë mos u bëj nga dyshuesit.<sup>13</sup>

أَفَعَيَّرَ اللَّهُ أَبْتَغَىٰ حَكَمًا وَ هُوَ الَّذِي أَنْزَلَ إِلَيْكُمْ الْكِتَابَ مَفْصَلًا ۗ وَ الَّذِينَ آتَيْنَاهُمُ الْكِتَابَ يَعْلَمُونَ أَنَّهُ مُنَزَّلٌ مِنْ رَبِّكَ بِالْحَقِّ فَلَا تَكُونَنَّ مِنَ الْمُمْتَرِينَ ﴿١١٥﴾

12. Fjalët, "njerëzit dhe xhindët", që përmenden në shumë ajete të Kuranit nuk nënkuptojnë dy lloje të ndryshme të krijesave të Zotit, por dy klasa të qenieve njerëzore; njerëzit e thjeshtë që përfaqësojnë masën dhe popullin e thjeshtë dhe "xhindët" që përfaqësojnë elitën, oligarkët dhe pushtetarët, të cilët shpesh janë të fshehtë nga njerëzit e thjeshtë. Fjala *xhin* në arabisht rrjedh nga *xhenne*, që do të thotë një send a krijesë e fshehtë. Lexoni edhe 6:129.

13. Fjalët e fundit të ajetit, "kurrë mos u bëj nga dyshuesit", i referohen lexuesit dhe jo Profetit

116. Fjala e Zotit tënd u përsos për nga vërtetësia e drejtësia. S'ka kush t'i ndërrojë fjalët e Tij. Ai është Gjithëdëgjuesi, i Gjithëdijshmi.

117. E nëse do t'i bindesh shumicës së atyre që janë në tokë, ata do të të devijojnë nga rruga e Allahut. Ata ndjekin vetëm hamendjen dhe vetëm trillojnë.

118. Zoti yt e njeh më së miri atë që ka devijuar nga rruga e Tij dhe, gjithashtu, Ai i njeh më së miri edhe ata që janë të udhëzuar.

119. Ndaj, hani vetëm nga ajo në të cilën u përmend emri i Allahut, nëse i besoni ajetet e Tij.<sup>14</sup>

120. E çfarë ju ndodhi që të mos hani nga ajo, në të cilën u përmend emri i Allahut, ndërkohë Ai ju ka shpjeguar me hollësi se çfarë ju ka ndaluar, përveç asaj për të cilën jeni shtrënguar (nga uria e madhe)? Pa dyshim, ka shumë që i devijojnë (të tjerët) me dëshirat e tyre, pa pasur dije. Zoti yt i di më së miri ata që e teprojnë.

121. Largohuni nga e dukshmja e mëkatit dhe nga brendia e tij. Ata që korrin mëkat, do të dënohen për atë që kanë bërë.

وَتَمَّتْ كَلِمَتُ رَبِّكَ صِدْقًا وَعَدْلًا ۗ لَا مُبَدِّلَ لِكَلِمَاتِهِ ۗ وَهُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ ﴿١١٦﴾

وَإِنْ تُطِيعْ أَكْثَرَ مَنْ فِي الْأَرْضِ يُضِلُّوكَ عَنْ سَبِيلِ اللَّهِ ۗ إِنْ يَتَّبِعُونَ إِلَّا الظَّنَّ وَإِنْ هُمْ إِلَّا يَخْرُصُونَ ﴿١١٧﴾

إِنَّ رَبَّكَ هُوَ أَعْلَمُ مَنْ يَضِلُّ عَنْ سَبِيلِهِ ۗ وَهُوَ أَعْلَمُ بِالْمُهْتَدِينَ ﴿١١٨﴾

فَكُلُوا مِمَّا ذُكِرَ اسْمُ اللَّهِ عَلَيْهِ إِنْ كُنْتُمْ بِآيَاتِهِ مُؤْمِنِينَ ﴿١١٩﴾

وَمَا لَكُمْ أَلَّا تَأْكُلُوا مِمَّا ذُكِرَ اسْمُ اللَّهِ عَلَيْهِ وَقَدْ فَضَّلَ لَكُمْ مَا حَرَّمَ عَلَيْكُمْ إِلَّا مَا اضْطُرِرْتُمْ إِلَيْهِ ۗ وَإِنَّ كَثِيرًا لَيُضِلُّونَ بِأَهْوَاءِهِمْ بِغَيْرِ عِلْمٍ ۗ إِنَّ رَبَّكَ هُوَ أَعْلَمُ بِالْمُعْتَدِينَ ﴿١٢٠﴾

وَذَرُوا ظَاهِرَ الْإِثْمِ وَبَاطِنَهُ ۗ إِنَّ الَّذِينَ يَكْسِبُونَ الْإِثْمَ سَيَجْرُونَ بِمَا كَانُوا يَفْعَرُونَ ﴿١٢١﴾

Muhammed<sup>savs</sup>. Për sa kohë që Librat e mëparshëm Hyjnorë, dhe po kështu edhe Kurani i Shenjtë japin dëshmi të forta për vërtetësinë e Profetit Muhammed<sup>savs</sup> dhe të zbulësës që i ka ardhur atij, lexuesi nuk ka justifikim të ushqejë dyshime rreth këtij fakti.

14. Ajetet 2:173 dhe 23:52 pohojnë se ushqimet kanë ndikim të drejtpërdrejtë në gjendjen shpirtërore të njeriut, andaj Zoti i porosit besimtarët që të hanë vetëm nga ushqimet e lejuara dhe në të cilat të përmendet edhe emri i Zotit, në mënyrë që t'u ruhet pastërtia mendore dhe shpirtërore. Lexoni edhe 5:6.



122. Mos hani nga ajo, në të cilën nuk është përmendur emri i Allahut, pa dyshim që ajo është e papastër. Djajtë patjetër do t'i frymëzojnë shokët e tyre që të grinden me ju. Nëse do t'u bindeni, do të jeni idhujtarë.

123. A mundet që ai që ishte i vdekur, të cilit Ne i dhamë jetë, i bëmë edhe dritë me të cilën ai ecën mes njerëzve, të jetë si ai që gjendet në errësira, sa s'ka për të dalë prej tyre?! Kështu u duket e bukur mohuesve ajo që bëjnë.<sup>15</sup>

124. Kështu, në çdo vendbanim kemi bërë prijësit e keqberësve të tij, që ata të bëjnë mashtrime në të. Ata nuk mashtrojnë askënd tjetër përveç vetvetes, por nuk ndërgjegjësohen.

125. E kur u vjen ndonjë shenjë, thonë: "Kurrë nuk do të besojmë, derisa nuk do të na jepet e njëjta (shenjë), që u është dhënë të Dërguarve të Allahut (më parë)." Allahu e di më së miri se ku të vendosë mesazhin e Tij. Keqberësit me siguri do t'i zërë poshtërimi para Allahut, si dhe një ndëshkim i fortë për mashtrimet që kanë bërë.

126. Pra, atij që Allahu do që ta udhëzojë, ia hap zemrën për Islamin dhe atij që Ai do që ta devijojë, ia bën

15. Në ajetet e mëparshme u theksua se ligjet e krijuara nga njeriu gjithmonë kanë mangësi. Ky ajet me fjalë të tjera pohon se mësimet e krijuara nga njeriu nuk mund të qëndrojnë përballë mësimëve Hyjnore. Shembulli i atyre që hartojnë ligje, pa u dritësuar nga Hyjnorja, është si ai që është i zhytur në errësirë, nga e cila nuk do të dalë kurrë. Ky ajet gjithashtu hedh dritë mbi temën se ç' domethënë ringjallja e të vdekurit në këtë botë.

وَلَا تَأْكُلُوا مِمَّا لَمْ يُذْكَرِ اسْمُ اللَّهِ عَلَيْهِ  
وَأَنَّهُ لَفَسْقٌ ۗ وَإِنَّ الشَّيْطَانَ لِيُوحِيَ  
أُولَئِهِمْ لِيُجَادِلُوكُمْ ۗ وَإِن أَعْطَمْتُمُوهُمْ  
إِنَّكُمْ لَمُشْرِكُونَ ﴿١٢٢﴾

أَوْ مَنْ كَانَ مَيِّتًا فَأَحْيَيْنَاهُ وَجَعَلْنَا لَهُ  
نُورًا يَمْشِي بِهِ فِي النَّاسِ كَمَنْ مَثَلَهُ فِي  
الظُّلُمَاتِ لَيْسَ بِخَارِجٍ مِنْهَا ۗ كَذَلِكَ زُيِّنَ  
لِلْكَافِرِينَ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿١٢٣﴾

وَكَذَلِكَ جَعَلْنَا فِي كُلِّ قَرْيَةٍ أَكْبَرًا  
مُجْرِمِيهَا لِيَمْكُرُوا فِيهَا ۗ وَمَا يَمْكُرُونَ  
إِلَّا بِأَنْفُسِهِمْ وَمَا يَشْعُرُونَ ﴿١٢٤﴾

وَإِذَا جَاءَتْهُمْ آيَةٌ قَالُوا لَنْ نُؤْمِنَ حَتَّى  
تُؤْتِيَ مَثَلَ مَا أُوتِيَ رَسُولُ اللَّهِ ۗ اللَّهُ أَعْلَمُ  
حَيْثُ يَجْعَلُ رِسَالَتَهُ ۗ سَيُصِيبُ الَّذِينَ  
أَجْرَمُوا صَغَارٌ عِنْدَ اللَّهِ وَعَذَابٌ شَدِيدٌ  
بِمَا كَانُوا يَمْكُرُونَ ﴿١٢٥﴾

فَمَنْ يُرِدِ اللَّهُ أَن يَهْدِيَهُ يَشْرَحْ صَدْرَهُ  
لِلْإِسْلَامِ ۗ وَمَنْ يُرِدْ أَن يُضِلَّهُ يَجْعَلْ  
صَدْرَهُ ضَيِّقًا حَرَجًا كَأْتَمَا يَصْعَدُ فِي

zemrën të ngushtë, të shtrënguar, sikur të ngjitej me mund në qiell. Kështu Allahu i lë të papastër, ata që nuk besojnë.

127. Dhe kjo është rruga e drejtë e Zotit tënd. Ne i kemi shpjeguar shenjat për njerëzit që kanë mend.

128. Ata kanë shtëpinë e paqes pranë Zotit të tyre dhe Ai është Miku i tyre për shkak të asaj që bëjnë.

129. Dhe (kini parasysh) ditën kur Ai do t'i tubojë të gjithë (dhe do t'u thotë): O grupi i xhindëve!<sup>16</sup> Keni nëpërkëmbur shumë nga njerëzit (e thjeshtë). Dhe miqtë e tyre prej njerëzve do të thonë: O Zoti ynë! Disa prej nesh kanë përfituar nga disa të tjerë dhe ja, kemi arritur tek afati ynë që Ti na e ke caktuar. Ai do t'u thotë: Zjarri është vendi juaj, ku do të mbeteni gjatë, përveç asaj që Allahu do. Sigurisht, Zoti yt është i Urtë, i

السَّمَاءِ ۗ كَذَلِكَ يَجْعَلُ اللَّهُ الرَّجَسَ عَلَى  
الَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ ﴿١٢٧﴾

وَهَذَا صِرَاطٌ رَبِّكَ مُسْتَقِيمًا ۗ قَدْ فَضَّلْنَا  
الْآيَاتِ لِقَوْمٍ يَذَّكَّرُونَ ﴿١٢٧﴾

لَهُمْ دَارُ السَّلَامِ عِنْدَ رَبِّهِمْ وَهُمْ وَلِيِّهِمْ بِمَا  
كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿١٢٨﴾

وَيَوْمَ يَحْشُرُهُمْ جَمِيعًا ۗ يَمَعَشَرَ الْجِنِّ قَدْ  
اسْتَكْبَرْتُمْ مِنَ الْإِنْسِ ۗ وَقَالَ أَوْلِيؤُهُمْ  
مِنَ الْإِنْسِ رَبَّنَا اسْتَمْتَعَ بَعْضُنَا بِبَعْضٍ  
وَوَبَلْنَا أَجَلَنَا الَّذِي أَجَلْتَنَا ۗ قَالَ  
الَّتَارُ مَثْوَاكُمْ خَلِدِينَ فِيهَا إِلَّا مَا شَاءَ

16. Kurani i Shenjtë dhe hadithet e Profetit<sup>savs</sup> fjalën xhind (arab. xhinn) e përmendin shpesh, por me kuptime të ndryshme. Bazuar në kuptimin rrënjësor të fjalës, konteksti sqaron se në çfarë kuptimi është përdorur në çdo rast. *Xhinn* në arabisht vjen nga folja *xhenne*, dhe kuptimi themelor i kësaj fjale është *e fshehtë*. Në arabisht, ka një mori fjalësh të prejardhura prej kësaj rrënje, të cilat e mbartin kuptimin e të qenit *i fshehtë*, *i padukshëm*. Për shembull, *xhenne*: mbuloj, përhijoj; *xhenin*: fetus. *xhunun*: çmenduri (sëmundja që errëson mendjen); *xhenan*: zemër (sepse është e fshehur); *xhenneh*: xhenet ose pemishte, që me pemët e saj të gjera e mbulon tokën; *xhann*: gjarpër (sepse rri i fshehur) etj.. Fjala *xhinn* u referohet krijesave të padukshme, edhe insekteve të padukshme ose mikroorganizmave. Profeti Muhammed<sup>savs</sup> porositi të mbulosh enën para se të flesh (Muslimi, Kitab el-eshrabeti, Bab el-emru bi-tagtijetil-inai), dhe në atë kohë kur njerëzit kishin një jetë primitive, i porositi të mos pastronin veten me bajgë apo me kocka, pasi ato ishin ushqimi i xhindëve. Përveç kësaj, fjala *xhinn* u përdor edhe për shpirtrat, të këqij apo të mirë. Andaj, konteksti tregon se çfarë kuptimi ka fjala *xhinn* në një ajet të caktuar. Kështu, kur *xhinn* përdoret bashkë me fjalën *ins* (njerëzit), të dyja fjalët së bashku nënkuptojnë dy kategori njerëzish: njerëzit e thjeshtë dhe njerëzit që vijnë nga shtresa e lartë dhe që për këtë arsye nuk janë të dukshëm për masën.

Gjithëdijshëm.<sup>17</sup>

اللَّهُ إِنَّ رَبَّكَ حَكِيمٌ عَلِيمٌ ﴿١٧﴾

130. Dhe kështu i ngarkojmë disa keqbërës mbi disa të tjerë për shkak të asaj që ata korrin.

وَكَذَلِكَ نُؤَيِّ بِعَصَ الظَّالِمِينَ بَعْضًا بِمَا كَانُوا يَكْسِبُونَ ﴿١٧﴾

131. O grupi i xhindëve dhe i njerëzve! A nuk ju kanë ardhur të Dërguar nga gjiri juaj, që ju tregonin shpalljet e Mia dhe ju paralajmëronin nga takimi i kësaj dite tuaj?! Ata do të thonë: “Dëshmojmë kundër vetes sonë!” Ata i mashtroi jeta e kësaj bote dhe ata dëshmuan kundër vetvetes që kanë qenë mohues.<sup>18</sup>

يَمْعَشِرَ الْجِنَّ وَالْإِنْسِ أَلَمْ يَأْتِكُمْ رَسُولٌ مِّنْكُمْ يَفْقُصُونَ عَلَيْكُمْ آيَاتِي وَيُنذِرُونَكُمْ لِقَاءَ يَوْمِكُمْ هَذَا قَالُوا شَهِدْنَا عَلَىٰ أَنفُسِنَا وَعَرَّثَهُمُ الْحَيَاةُ الدُّنْيَا وَشَهِدُوا عَلَىٰ أَنفُسِهِمْ أَنَّهُمْ كَانُوا كَفِرِينَ ﴿١٨﴾

132. Kështu (do të ndodhë), sepse Zoti yt nuk shkatërron ndonjë vendbanim padrejtësisht, kur banorët e tij janë të pavetëdijshëm.

ذَلِكَ أَنْ لَّمْ يَكُنْ رَبُّكَ مُهْلِكَ الْقُرَىٰ بِظُلْمٍ وَأَهْلُهَا غَفْلُونَ ﴿١٨﴾

133. Dhe për të gjithë ka grada, sipas asaj që kanë bërë. Zoti yt nuk është i pavëmendshëm ndaj asaj që ata bëjnë.

وَلِكُلِّ دَرَجَاتٍ مِّمَّا عَمِلُوا وَمَا رَبُّكَ بِغَافِلٍ عَمَّا يَعْمَلُونَ ﴿١٩﴾

17. Edhe fjalët e këtij ajeti dëshmojnë faktin se *xhindët* këtu nënkuptojnë një shtresë të caktuar njerëzish, pushtetarët dhe oligarkët, sepse janë pikërisht këta të cilët shpesh nëpërkëmbin njerëzit e thjeshtë. Në asnjë vend të botës nuk ndodh që një qenie e padukshme mbinjerëzore të nëpërkëmb masën dhe popullin e thjeshtë. Temë e ngjashme me këtë përmendet edhe në 72:7. Gjithashtu, as në Kuran nuk përmendet që Zoti t' u ketë dërguar xhindëve profetë xhindë. Lexoni edhe 6:113.

18. Edhe në këtë ajet “grupi i xhindëve” nënkupton njerëzit e fuqishëm. Nëse nuk do ta interpretojmë në këtë mënyrë, atëherë lind pyetja se të dërguarit xhindë që u vinin xhindëve, përse nuk u dhanë ndonjë lajm të mirë të xhenetit për veprat e tyre të mira? Në asnjë ajet të Kuranit dhe në asnjë hadith nuk përmendet prania e xhindëve në xhenet.

134. Dhe Zoti yt është i Vetëmjaftueshëm, i zoti i mëshirës. Po të dojë Ai, do t'ju largojë dhe do t'ju zëvendësojë me dikë që e do, ashtu siç ju ka ngritur ju nga pasardhësit e një populli tjetër.

135. Për atë që paralajmëroheni, patjetër do të vijë. Ju nuk mund ta ndalni.

136. Thuaju: O populli im! Veproni në anën tuaj atë që keni për të vepruar, edhe unë do të veproj. Së shpejti do të mësoni se e kujt do të jetë shtëpia në fund. Sigurisht, keqbërësit nuk gëzojnë sukses.

137. Dhe ata i kanë përcaktuar Allahut një pjesë nga drithërat dhe bagëtitë që Ai ka krijuar. Me mendjen e tyre thanë: “Kjo është për Allahun dhe kjo është për idhujt tanë.” E (sipas tyre), ajo që është për idhujt e tyre, nuk arrin tek Allahu, kurse ajo që është për Allahun, arrin tek idhujt e tyre. Sa keq gjykojnë!

138. Dhe kështu, idhujt e tyre i kanë treguar të zbukuruar shumicës së idhujtarëve vrasjen e fëmijëve të tyre, në mënyrë që t'i shkatërrojnë ata dhe t'i vënë në mëdyshje për besimin e tyre. Po të donte Allahu, ata nuk do ta bënë këtë, andaj lëri ata dhe trillimet e tyre.

139. Dhe me mendjen e tyre thonë: “Këto bagëti dhe drithëra janë të ndaluara; të mos i ha njeri, përveç

وَرَبُّكَ الْعَنِّي ذُو الرَّحْمَةِ ۗ إِنَّ يَسَاءَ  
يُدْهَبُكُمْ وَيَسْتَخْلِفُ مِنْ بَعْدِكُمْ مَا يَشَاءُ  
كَمَا أَنْشَأَكُمْ مِنْ ذُرِّيَّةٍ قَوْمٍ آخَرِينَ ﴿٣٤﴾

إِنَّ مَا تُوْعَدُونَ لَأْتِي ۗ وَ مَا أَنْتُمْ  
بِمُعْجِزِينَ ﴿٣٥﴾

قُلْ يَقَوْمِ اعْمَلُوا عَلَىٰ مَكَانَتِكُمْ ۗ إِنِّي  
عَامِلٌ ۚ فَسَوْفَ تَعْلَمُونَ ۗ مَنْ تَكُونُ لَهُ  
عَاقِبَةُ الدَّارِ ۗ إِنَّهُ لَا يُفْلِحُ الظَّالِمُونَ ﴿٣٦﴾

وَجَعَلُوا لِلَّهِ إِيمَانًا ذَرَأَ مِنَ الْحَرْثِ وَالْأَنْعَامِ  
نَصِيبًا فَقَالُوا هَذَا لِلَّهِ بِرِزْعِهِمْ وَهَذَا  
لِشُرَكَائِنَا ۗ فَمَا كَانَ لِشُرَكَائِهِمْ فَلَا يَصِلُ  
إِلَى اللَّهِ ۗ وَمَا كَانَ لِلَّهِ فَهُوَ يَصِلُ ۗ إِلَى  
شُرَكَائِهِمْ ۗ سَاءَ مَا يَحْكُمُونَ ﴿٣٧﴾

وَكَذَلِكَ زَيَّنَ لِكَثِيرٍ مِنَ الْمُشْرِكِينَ قَتْلَ  
أَوْلَادِهِمْ شُرَكَائِهِمْ ۗ لِيُرَدُّوهُمْ وَلِيَلْبِسُوا  
عَلَيْهِمْ دِينَهُمْ ۗ وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ مَا فَعَلُوهُ  
فَذَرَهُمْ وَمَا يَفْتَرُونَ ﴿٣٨﴾

وَقَالُوا هَذِهِ أَنْعَامٌ وَ حَرَّتْ حِجْرٌ  
لَّا يَطْعَمُهَا إِلَّا مَنْ نَشَاءُ بِرِزْعِهِمْ

atyre që ne duam, e disa kafshë shtëpiake janë të ndaluara për ngarkesë”. Disa kafshëve të tjera ata nuk u përmendnin emrin e Allahut, duke trilluar mbi Të. Ai me siguri do t'i ndëshkojë ata për trillimet e tyre.

140. Dhe thonë: “Ajo që gjendet në barkun e këtyre kafshëve është vetëm për meshkujt tanë dhe është e ndaluar për bashkëshortet tona. E nëse është e ngordhur, të gjithë do të jenë pjesëmarrës në të”. Ai patjetër do t'i dënojë ata për shpjegimin e tyre. Sigurisht, Ai është i Urtë, i Gjithëdhijshëm.

141. Kanë humbur ata që vranë fëmijët e vet nga budallallëku dhe padituria, dhe i quajtën të ndaluara ato që Allahu u kishte dhënë, duke trilluar mbi Allahun. Ata me siguri kanë devijuar dhe nuk ishin të udhëzuar.

142. Është Ai që prodhoi kopshte, të varura dhe jo të varura, hurmat, drithërat, që kanë shije të ndryshme, ullirin, shegën, të ngjashme e jo të ngjashme. Hani nga frutat e tyre kur ato piquen dhe jepni detyrimin e tyre ditën e vjeljes dhe mos i shpërdoroni. Sigurisht, Ai nuk i do shpërdoruesit.

143. Ndër kafshët (Ai ka krijuar) edhe kafshë ngarkese dhe shale. Hani nga ajo që Allahu ju ka dhuruar dhe mos ndiqni gjurmët e djallit;

وَأَنْعَامٍ حُرِّمَتْ ظُهُورُهَا وَأَنْعَامٍ  
لَّا يَذْكُرُونَ اسْمَ اللَّهِ عَلَيْهَا افْتِرَاءً  
عَلَيْهِ سَيَجْزِيهِمْ بِمَا كَانُوا يَفْتَرُونَ ﴿٣٩﴾

وَقَالُوا مَا فِي بُطُونِ هَذِهِ الْأَنْعَامِ خَالِصَةٌ  
لِّذُنُورِنَا وَمُحَرَّمٌ عَلَىٰ أَرْوَاجِنَا ۗ وَإِن  
يَكُن مَّيْتَةً فَهُمْ فِيهِ شُرَكَاءُ ۗ سَيَجْزِيهِمْ  
وَصَفَّهُمْ ۗ إِنَّهُ حَكِيمٌ عَلِيمٌ ﴿٤٠﴾

قَدْ خَسِرَ الَّذِينَ قَتَلُوا أَوْلَادَهُمْ سَفَهًا  
بِغَيْرِ عِلْمٍ وَحَرَّمُوا مَا رَزَقَهُمُ اللَّهُ  
افْتِرَاءً عَلَى اللَّهِ ۗ قَدْ ضَلُّوا وَمَا كَانُوا  
مُهْتَدِينَ ﴿٤١﴾

وَهُوَ الَّذِي أَنْشَأَ جَنَّاتٍ مَّعْرُوشَاتٍ وَغَيْرِ  
مَّعْرُوشَاتٍ وَالنَّخْلَ وَالزَّرْعَ مُخْتَلِفًا  
أَلْوَانُهُ وَالزَّيْتُونَ وَالرَّمَانَ مَتَشَابِهًا  
وَغَيْرَ مُتَشَابِهٍ ۗ كُلُوا مِنْ ثَمَرِهِ إِذَا أَثْمَرَ  
وَآتُوا حَقَّهُ يَوْمَ حَصَادِهِ ۗ وَلَا تُسْرِفُوا ۗ إِنَّهُ  
لَا يُحِبُّ الْمُسْرِفِينَ ﴿٤٢﴾

وَمِنَ الْأَنْعَامِ حَمُولَةٌ ۗ وَفَرَسَاتٌ ۗ كُلُوا مِنْهَا  
رَزَقَكُمُ اللَّهُ ۗ وَلَا تَتَّبِعُوا خُطُوَاتِ الشَّيْطَانِ ۗ

ai përnjëmend është armiku juaj i hapët.

144. (Allahu ka krijuar) tetë çifte. Dy prej deleve dhe dy prej dhive. Pyeti: A i ka ndaluar Ai dy meshkuj apo dy femra (prej tyre), apo atë që kanë mbështjellë mitrat e dy femrave?! Tregomëni pra, në bazë të ndonjë dijeje, nëse thoni të vërtetën!

145. Po ashtu, dy prej deveve dhe dy prej lopëve. Pyeti: A i ka ndaluar Ai dy meshkuj apo dy femra (prej tyre), apo atë që kanë mbështjellë mitrat e dy femrave?! Apo ishit dëshmitarë kur Allahu jua ka dhënë këtë porosi?! E kush mund të jetë më keqbërës sesa ai që trillon gënjeshtria mbi Allahun, që t'i devijojë njerëzit pa pasur dije?! Sigurisht, Allahu nuk udhëzon njerëzit e padrejtë.

146. Thuaju: Në atë që më është shpallur mua, nuk gjej asnjë ushqim të ndaluar që të hajë dikush, përveç ngordhësirës, gjakut të derdhur, mishit të dërrit – sepse ai është i ndyrë – ose të papastrës (pra), që është therur a blatur në emër jo të Allahut. Por për atë që shtrëngohet, pa qenë lakmues dhe shkelës, Zoti yt pa dyshim është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

147. Për hebrenjtë kishim ndaluar çdo kafshë me kthetra. Dhe nga lopët dhe dhentë ua kishim ndaluar dhjamërat e tyre, përveç atij që

إِنَّهُ لَكُمْ عَدُوٌّ مُّبِينٌ ﴿١٤٢﴾

ثُمْنِيَّةَ أَرْوَاحٍ ۚ مِنَ الصَّانِ اثْنَيْنِ وَمِنَ  
الْمَعْرِ اثْنَيْنِ ۖ قُلْ آلذَّكَرَيْنِ حَرَّمَ أَمَ  
الْأُنثِيَيْنِ أَمَا اشْتَمَلَتْ عَلَيْهِ أَرْحَامٌ  
الْأُنثِيَيْنِ ۖ تَبَيَّنَ لِي بِعِلْمٍ إِن كُنْتُمْ  
صَادِقِينَ ﴿١٤٤﴾

وَمِنَ الْإِبِلِ اثْنَيْنِ وَمِنَ الْبَقَرِ اثْنَيْنِ ۖ  
قُلْ آلذَّكَرَيْنِ حَرَّمَ أَمَ الْأُنثِيَيْنِ أَمَا  
اشْتَمَلَتْ عَلَيْهِ أَرْحَامُ الْأُنثِيَيْنِ ۖ أَمْ كُنْتُمْ  
شُهَدَاءَ إِذْ وَصَّكُمْ اللَّهُ بِهَذَا ۚ فَمَنْ  
أَظْلَمُ مِمَّنِ افْتَرَى عَلَى اللَّهِ كَذِبًا يُضِلُّ  
النَّاسَ بِغَيْرِ عِلْمٍ ۖ إِنَّ اللَّهَ لَا يَهْدِي  
الْقَوْمَ الظَّالِمِينَ ﴿١٤٥﴾

قُلْ لَا آجِدُ فِي مَا أُوحِيَ إِلَيَّ مُحَرَّمًا عَلَى  
طَاعِمٍ يَطْعَمُهُ إِلَّا أَنْ يَكُونَ مَيْتَةً  
أَوْ دَمًا مَسْفُوحًا أَوْ لَحْمَ خِنزِيرٍ فَإِنَّهُ  
رِجْسٌ أَوْ فِسْقًا أُهْلَ لِغَيْرِ اللَّهِ بِهِ ۚ فَمَنْ  
اضْطُرَّ غَيْرَ بَاغٍ وَلَا عَادٍ فَإِنَّ رَبَّكَ  
غَفُورٌ رَحِيمٌ ﴿١٤٦﴾

وَعَلَى الَّذِينَ هَادُوا حَرَّمْنَا كُلَّ ذِي ظُفْرِ ۚ  
وَمِنَ الْبَقَرِ وَالْغَنَمِ حَرَّمْنَا عَلَيْهِمْ

gjendet në shpinat e tyre, në zorrët (e tyre) ose atij që është i mbështjellë me kockat. Kështu i dënuam ata për shkak të rebelimit të tyre, dhe Ne sigurisht jemi të drejtë.<sup>19</sup>

148. Nëse të quajnë gënjeshtar, thuaju: Zoti juaj zotëron mëshirë shumë të madhe, por ndëshkimi i Tij nuk mund të sprapset nga populli fajtor.

149. Idhujtarët me siguri do të thonë: “Po të donte Allahu, nuk do të bënim idhujtari as ne e as etërit tanë dhe as nuk do të quanim diçka si të ndaluar.” Kështu mohuan ata që ishin para tyre, derisa e shijuan ndëshkimin Tonë. Pyeti: A keni ndonjë dije, që të na tregoni? Ju ndiqni veç hamendjen dhe vetëm gënjeni.

150. Thuaju: I Allahut është argumenti përfundimtar. Pra, nëse do të donte Ai, do t’ju udhëzonte të gjithë ju.

151. Thuaju: Thirrni dëshmitarët tuaj, që të dëshmojnë se këtë e ka ndaluar Allahu. E nëse ata e dëshmojnë, ti mos dëshmo me ta. Mos ndiq dëshirat e atyre që i quajtën gënjeshtër ajetet Tona, që nuk besojnë në *ahiret* dhe që barazojnë (dikë a diçka) me Zotin e tyre.

سُحُومَهُمَا إِلَّا مَا حَمَلَتْ ظُهُورُهُمَا  
أَوِ الْحَوَايَا أَوْ مَا اخْتَلَطَ بِعَظْمٍ ۗ ذَٰلِكَ  
جَزَايُهُمْ بِبَعْثِهِمْ ۗ وَإِنَّا لَصَدِيقُونَ ﴿١٤٧﴾

فَإِن كَذَّبُوكَ فَقُلْ رَبُّكُمْ ذُو رَحْمَةٍ  
وَاسِعَةٍ ۗ وَلَا يُرَدُّ بَأْسُهُ عَنِ الْقَوْمِ  
الْمُجْرِمِينَ ﴿١٤٨﴾

سَيَقُولُ الَّذِينَ أَشْرَكُوا لَوْ شَاءَ اللَّهُ مَا  
أَشْرَكْنَا وَلَا آبَاؤُنَا وَلَا حَرَمْنَا مِنْ شَيْءٍ ۗ  
كَذَٰلِكَ كَذَّبَ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ حَتَّى  
ذَاقُوا بَأْسَنَا ۗ قُلْ هَلْ عِنْدَكُمْ مِنْ عِلْمٍ  
فَتُخْرِجُوهُ لَنَا ۗ إِن تَتَّبِعُونَ إِلَّا الظَّنَّ وَإِنْ  
أَنْتُمْ إِلَّا تَخْرُصُونَ ﴿١٤٩﴾

قُلْ فَلِلَّهِ الْحُجَّةُ الْبَالِغَةُ ۗ فَلَوْ شَاءَ  
لَهَدَيْتُكُمْ أَجْمَعِينَ ﴿١٥٠﴾

قُلْ هَلَمْ شُهِدَآءُكُمْ الَّذِينَ يَشْهَدُونَ أَنَّ  
اللَّهَ حَرَّمَ هَٰذَا ۗ فَإِنْ شَهِدُوا فَلَا تَشْهَدُ  
مَعَهُمْ ۗ وَلَا تَتَّبِعْ أَهْوَاءَ الَّذِينَ كَذَّبُوا  
بِآيَاتِنَا وَالَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ بِالْآخِرَةِ وَهُمْ  
بِرَبِّهِمْ يَعْدِلُونَ ﴿١٥١﴾

19. Lexoni: Bibla, Levitiku 3:17 dhe 7:23. Në Talmud përmendet përjashtimi për dhjamërat në shpinat e kafshëve të përmendura në këtë ajet.

152. Thuaju: Ejani t'ju lexoj atë që ju ka ndaluar Zoti juaj: asgjë mos e bëni ortak me Të dhe (ju obligoi) mirësinë ndaj prindërve; mos vritni fëmijët tuaj nga frika e skamjes, Ne ju ushqejmë edhe ju, edhe ata; mos iu afroni paturpësive, as të dukshmes e as të padukshmes së tyre; dhe mos vritni asnjë njeri që ka ndaluar Allahu, përveçse me drejtësi! Kjo është ajo që ju ka porositur Ai, që ju të punoni me mend.

153. Dhe mos iu afroni pasurisë së jetimit, përveçse në mënyrën më të mirë, derisa ai të arrijë pjekurinë e tij; përmbushni masën dhe peshën me drejtësi; Ne nuk ngarkojmë asnjë shpirt përtej kapacitetit të tij; kur flisni, flisni me drejtësi edhe sikur tjetri të jetë ndonjë i afërm (juaji); dhe përmbushni premtimin e Allahut. Kjo është ajo që ju ka porositur Ai, që ju të reflektoni.

154. (Porositi gjithashtu): Kjo është rruga ime e drejtë, andaj, këtë ndiqeni dhe mos ndiqni rrugët e tjera, sepse ato ju largojnë nga rruga e Tij. Kjo është ajo që ju ka porositur Ai, që ju të keni druajtje (ndaj Tij).

155. Pastaj, Ne i dhamë Musait Librin, të përsosur për çdokënd që bënte mirësi, të shtjelluar për çdo gjë dhe ishte udhëzim e mëshirë, që ata të besonin në takimin me Zotin e tyre.

قُلْ تَعَالَوْا أَتْلُ مَا حَرَّمَ رَبِّيَ عَلَيْكُمْ  
أَلَّا تُشْرِكُوا بِهِ شَيْئًا وَبِالْوَالِدَيْنِ إِحْسَانًا  
وَلَا تَقْتُلُوا أَوْلَادَكُمْ مِمَّنْ أَمْلَاقٌ نَحْنُ  
نَرَزُقُكُمْ وَإِيَّاهُمْ ۖ وَلَا تَقْرَبُوا الْفَوَاحِشَ  
مَا ظَهَرَ مِنْهَا وَمَا بَطْنَ ۚ وَلَا تَقْتُلُوا  
النَّفْسَ الَّتِي حَرَّمَ اللَّهُ إِلَّا بِالْحَقِّ ۗ ذِكْرُكُمْ  
وَلَكُمْ بِهِ لَعَلَّكُمْ تَعْقِلُونَ ﴿١٥٢﴾

وَلَا تَقْرَبُوا مَالَ الْيَتِيمِ إِلَّا بِالَّتِي هِيَ  
أَحْسَنُ حَتَّىٰ يَبْلُغَ أَشُدَّهُ ۚ وَأَوْفُوا الْكَيْلَ  
وَالْمِيزَانَ بِالْقِسْطِ ۚ لَا تَكْلِفُ نَفْسًا  
إِلَّا وُسْعَهَا ۚ وَإِذَا قُلْتُمْ فَاعْدِلُوا وَلَوْ كَانَ  
ذَا قُرْبَىٰ ۚ وَبِعَهْدِ اللَّهِ أَوْفُوا ۗ ذِكْرُكُمْ  
وَلَكُمْ بِهِ لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ ﴿١٥٣﴾

وَأَنَّ هَذَا صِرَاطٌ مُسْتَقِيمٌ فَاتَّبِعُوهُ ۚ وَلَا  
تَتَّبِعُوا السُّبُلَ فَتَفَرَّقَ بِكُمْ عَنْ سَبِيلِهِ ۗ  
ذِكْرُكُمْ وَلَكُمْ بِهِ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ ﴿١٥٤﴾

ثُمَّ آتَيْنَا مُوسَى الْكِتَابَ تَمَامًا عَلَى الَّذِي  
أَحْسَنَ وَتَفْصِيلًا لِكُلِّ شَيْءٍ ۚ وَهُدًى  
بُرْهَانًا وَعِلْمًا لِّعَالَمِهِمْ بِإِقْدَارِ رَبِّهِمْ ۗ يُؤْمِنُونَ ﴿١٥٥﴾



156. Dhe ky që kemi zbritur është Libër i bekuar, prandaj, ndiqeni këtë dhe kini druajtje (ndaj Zotit), që të mëshiroheni.

157. Që të mos thoni: “Libri iu zbrit dy popujve përpara nesh dhe kemi qenë të pavëmendshëm ndaj studimit të tyre.”<sup>20</sup>

158. Ose, të mos thoni: “Sikur neve të na zbritte Libri, do të ishim më të udhëzuar se ata.” Tashmë juve ju ka ardhur nga Zoti juaj një provë e qartë, udhëzim dhe mëshirë. E kush mund të jetë më keqbërës sesa ai që i quan gënjeshtër ajetet e Allahut dhe shmanget nga ato?! Ata që u shmangen ajeteve Tona, me siguri do t'i ndëshkojmë me një ndëshkim të keq, për shkak se shpërfillnin.

159. Apo ata presin vetëm që t'u vijjë engjëjt ose t'u vijë Zoti yt ose disa nga shenjat e Zotit tënd?! Kur do t'u vijjë disa nga shenjat e Zotit tënd, nuk do t'i bëjë dobi besimi i atij që nuk ka besuar deri më parë, ose që nuk ka bërë ndonjë mirësi në besimin e tij. Thuaju: Prisni, edhe ne po presim.

وَهَذَا كِتَابٌ أَنْزَلْنَاهُ مُبْرَكًا فَاتَّبِعُوهُ  
وَاتَّقُوا لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ ﴿٥٦﴾

أَنْ تَقُولُوا إِنَّمَا أَنْزَلَ الْكِتَابَ عَلَى  
طَائِفَتَيْنِ مِنْ قَبْلِنَا وَإِنْ كُنَّا عَنْ  
دِرَاسَتِهِمْ لَغَفِيلِينَ ﴿٥٧﴾

أَوْ تَقُولُوا لَوْ أَنَّا أَنْزَلْنَا عَلَيْكَ الْكِتَابَ  
لَكُنَّا أَهْدَىٰ مِنْهُمْ فَقَدْ جَاءَكُمْ بَيِّنَةٌ  
مِّن رَّبِّكُمْ وَهَدَىٰ وَرَحْمَةً فَمَنْ أَظْلَمُ  
مِمَّنْ كَذَبَ بِآيَاتِ اللَّهِ وَصَدَفَ عَنْهَا  
سَجَزَىٰ الَّذِينَ يَصْدِفُونَ عَن آيَاتِنَا سَوْءَ  
الْعَذَابِ بِمَا كَانُوا يَصْدِفُونَ ﴿٥٨﴾

هَلْ يَنْظُرُونَ إِلَّا أَنْ تَأْتِيَهُمُ الْمَلٰٓئِكَةُ  
أَوْ يَأْتِي رَبُّكَ أَوْ يَأْتِي بَعْضُ آيَاتِ رَبِّكَ  
يَوْمَ يَأْتِي بَعْضُ آيَاتِ رَبِّكَ لَا يَنْفَعُ نَفْسًا  
إِيمَانُهَا لَمْ تَكُنْ آمَنَتْ مِنْ قَبْلُ أَوْ  
كَسَبَتْ فِي إِيمَانِهَا خَيْرًا ۗ قُلِ اتَّظِرُوا  
إِنَّا مُتَّظِرُونَ ﴿٥٩﴾

20. Fjalët “dy popujve përpara nesh” mund të nënkuptojnë popullin hebre, që janë ithtarët e Teuratit dhe që morën zanafillën në zonën veriore të Arabisë, si dhe popullin zoroastrian, të cilët kishin Librin Zend-Avesta dhe që jetuan në zonën lindore të Arabisë. Ose mund të nënkuptojnë hebrenjtë dhe të krishterët, pra dy popuj që jetuan në Arabi, me të cilët arabët kanë pasur marrëdhënie.

160. Ata që copëtuan fenë e tyre dhe u ndanë nëpër grupe, ti nuk ke asnjë lidhje me ta. Çështja e tyre është tek Allahu. Pastaj, Ai do t'u tregojë se çfarë bënin ata.

161. Ai që bën mirësi, do të ketë dhjetëfishin e saj, kurse ai që bën ligësi, do të dënohet për aq sa ka bërë. Atyre nuk do t'u bëhet padrejtësi.

162. Thuaju: Zoti im më ka përudhur në rrugën e drejtë, (të cilën e bëri si) një fe të qëndrueshme (dhe) grup të Ibrahimit të nënshtruar (ndaj Zotit). (Ibrahimi) nuk ishte nga idhujtarët.

163. Thuaju: Sigurisht, namazi im, sakrificat e mia, jeta ime dhe vdekja ime janë për Allahun, Zotin e botëve.<sup>21</sup>

164. Ai nuk ka ortak. Unë për këtë jam urdhëruar dhe jam i pari nga muslimanët.

165. Thuaju: A të pëlqej zot tjetër përveç Allahut, kur Ai është Zoti i çdo gjëje?! Çdo punë (të keqe) që bën një shpirt, e bën kundër vetvetes. Asnjë mbartës nuk do të mbajë barrën e

إِنَّ الَّذِينَ فَرَقُوا دِينَهُمْ وَكَانُوا شِيعًا  
لَسَتْ مِنْهُمْ فِي شَيْءٍ إِنَّمَا أَمْرُهُمْ إِلَى  
اللَّهِ ثُمَّ يُنَبِّئُهُمْ بِمَا كَانُوا يَفْعَلُونَ ﴿١٦٠﴾

مَنْ جَاءَ بِالْحَسَنَةِ فَلَهُ عَشْرُ أَمْثَالِهَا  
وَمَنْ جَاءَ بِالسَّيِّئَةِ فَلَا يُجْزَى إِلَّا مِثْلَهَا  
وَهُمْ لَا يُظْلَمُونَ ﴿١٦١﴾

قُلْ إِنِّي هَدَيْتُ رَبِّي إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ  
دِينًا قِيمًا مِثْلَ إِبْرَاهِيمَ حَنِيفًا وَمَا كَانَ  
مِنَ الْمُشْرِكِينَ ﴿١٦٢﴾

قُلْ إِنَّ صَلَاتِي وَنُسُكِي وَمَحْيَايَ وَمَمَاتِي  
لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿١٦٣﴾

لَا شَرِيكَ لَهُ ۚ وَبِذَلِكَ أُمِرْتُ وَأَنَا أَوَّلُ  
الْمُسْلِمِينَ ﴿١٦٤﴾

قُلْ أَعْيَرَ اللَّهُ أَبْعَى رَبًّا وَهُوَ رَبُّ كُلِّ  
شَيْءٍ ۗ وَلَا تَكْسِبُ كُلُّ نَفْسٍ إِلَّا عَلَيْهَا  
وَلَا تَزِرُ وَازِرَةٌ وِزْرَ أُخْرَى ۗ ثُمَّ إِلَى

21. Thuaju atyre: Adhurimi im, sakrifica ime, jeta ime dhe vdekja ime janë në rrugën e Zotit, pra janë për të shfaqur madhësinë e Tij dhe për t'u mundësuar rehati robërve të Tij, në mënyrë që ata të gëzojnë jetën nga vdekja ime. Kështu ky ajet tregon që Hazret Profeti Muhammed<sup>savs</sup> vetëm nga dhembshuria ndaj njerëzimit u mundua aq shumë, saqë ua përkushtoi jetën duke bërë lutje, duke u përcjellë atyre mesazhin Hyjnor, duke duruar mizoritë dhe sflitjet e tyre dhe duke praktikuar çdo metodë të denjë e të urtë. Ai e kishte flijuar jetën dhe rehatinë e vet në rrugën e Zotit.

tjetrit.<sup>22</sup> Më pas, te Zoti juaj është kthimi juaj dhe Ai do t'ju tregojë për çështjet në të cilat kundërshtoni njëri-tjetrin.

رَبِّكُمْ مَرْجِعُكُمْ فَيُنَبِّئُكُمْ بِمَا كُنتُمْ فِيهِ تَخْتَلِفُونَ ﴿١٦٥﴾

166. Është Ai që ju bëri mëkëmbës të tokës dhe disa prej jush i ngriti në grada mbi disa të tjerë, në mënyrë që t'ju sprovtojë në ato çka ju ka dhënë Ai. Sigurisht, Zoti yt është i shpejtë në llogari dhe sigurisht, Ai është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

وَهُوَ الَّذِي جَعَلَكُمْ خَلَيفَ الْأَرْضِ وَرَفَعَ بَعْضَكُمْ فَوْقَ بَعْضٍ دَرَجَاتٍ لِيَبْلُوَكُمْ فِي مَا آتَاكُمْ ۗ إِنَّ رَبَّكَ سَرِيعُ الْعِقَابِ ۗ وَإِنَّهُ لَغَفُورٌ رَّحِيمٌ ﴿١٦٦﴾

22. Në hadith përmendet që kur *Hazret Omeri*<sup>ra</sup> u plagos (plagë e cila do t'i shkaktonte vdekjen), *Suhejbi*<sup>ra</sup> e vizitoi dhe iu drejtua duke qarë. Atëherë *Hazret Omeri*<sup>ra</sup> i tha – Pse po qan për mua, o *Suhejb*? A nuk e di fjalën e të Dërguarit të Allahut që kur familjarët qajnë përpara të vdekurit të tyre, ata i shkaktojnë ndëshkim! Kur *Hazret Omeri*<sup>ra</sup> ndërroi jetë, *Ibni Abbasi*<sup>ra</sup> thotë – ia tregova gjithë ngjarjen *Aishes*<sup>ra</sup>. Atëherë ajo iu përgjigj – Zoti e mëshiroftë Omerin! I Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> nuk tha një gjë të tillë; juve ju mjafton Kurani ku Allahu thotë: “*asnjë mbartës nuk do të mbajë barrën e tjetrit*” (6:165). *Hazret Aishja*<sup>ra</sup> sapo e dëgjoi hadithin, e refuzoi sepse binte ndesh me ajetin e Kuranit, dhe familjarët e dashur të një të vdekuri më kot do t'i bënte ndëshkues të tij. Ajo tregoi fjalët e hadithit ndryshe nga ato që mendonte *Hazret Omeri* duke thënë se kjo nuk është për besimtarët, por për mohuesit (Buhari, nr. 1288), sepse ata vetë e kërkonin vajtimin për vdekjen e tyre, madje edhe linin amanet që familjarët të vajtonin për ta. E gjithë kjo tregon se hadithi që bie ndesh me Kuranim, ose duhet interpretuar, ose duhet refuzuar. Kurani është gjykatës mbi hadithin (42:11) dhe jo e kundërta. Hadithi është në shërbim të Kuranit dhe të sunetit të Profetit<sup>savs</sup>. Lexoni edhe 45:7 dhe 33:22.

## Surja 7 – El-A'raf

Surja El-A'raf, me përjashtim të disa ajeteve, zbriti në Mekë. Bashkë me *bismil-lahin*, ajo ka dyqind e shtatë ajete.

Dy suret paraardhëse, El-Bekare dhe Ali Imran, fillojnë me shkurtesat kuranore *Elif.Lam.Mim.* Ndërsa kësaj sureje, përveç shkronjave *Elif.Lam.Mim.*, i shtohet edhe shkronja *Sad*. Kjo tregon qartazi se kjo sure do të sjellë diçka shtesë në temat e saj, e cila ka lidhje me atributin *Sadik* (I Vërtetë) të Zotit të Madhërishëm.

Me shkronjën *sad* nënkuptohet edhe "*Sadikul-kaul*" (I vërteti ose i drejti në fjalë), gjithashtu, në ajetin e tretë të kësaj sureje përmendet kraharori i Profetit Muhammed<sup>savs</sup> me fjalën "*sadr*", gjë që dëshmon se Profeti<sup>savs</sup> ka pasur besim të plotë (*inshirah sadr*) në temat që janë përmendur në suret me shkronjat *Elif.Lam.Mim.* dhe që ato ishin prej Zotit të Lartësuar.

Një temë shtesë që sjell kjo sure është ajo, që nuk do të pyeten vetëm njerëzit që kanë mohuar Profetët, por do të pyeten edhe Profetët që deri në çfarë shkalle ata i përmbushën përgjegjësitë e tyre.

Edhe një herë përmendet *Hazret Ademi* në këtë sure, të cilin Zoti i Madhërishëm e krijoi me urdhrin (*emrin*) e Tij dhe kur fryu në të shpirtin prej Tij, urdhëroi njerëzimin që t'i bindet atij. Realisht, sexhden më madhore pranë Zotit e kishte bërë Profeti Muhammed<sup>savs</sup>, gjë që thuhet në fund të sures paraardhëse, në fjalët: "*Thuaju: Sigurisht, namazi im, sakrificat e mia, jeta ime dhe vdekja ime janë për Allahun, Zotin e botëve*". Këtu shpaloset që Zoti i Madhërishëm porositi gjithë njerëzimin që t'i bindet Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, në nder të sexhdes madhore që ai bëri ndaj Tij. Ai që i ka përkushtuar gjithçka vetëm Zotit të Lartësuar, nuk është aspak *shirk* të përulesh me nderim para tij. Bindja ndaj tij është bindje ndaj Zotit të Lartësuar.

Në vazhdim flitet për veshjen e Ademit<sup>as</sup>, e cila në dukje ishte veshje prej gjethesh, por në të vërtetë ajo ka qenë veshja e *takvasë*, pra, e druajtjes ndaj Zotit (*libasut-takva*). Gjithashtu, paralajmërohen njerëzit që ashtu siç djalli e devijoi një herë popullin e Ademit, ai edhe sot i devijon popujt e Profetëve të tjerë. Këtu përputhet kuptimi që dalje nga xheneti në radhë të parë do të thotë dalje nga porositi e Zotit (*nga Sheriati*), sepse xheneti qëndron pikërisht brenda rrethit të porosive të Zotit dhe se jashtë tyre ka vetëm xhehenem. Edhe sot, njerëzit janë të përfshirë në shumë lloj xhehenemesh, fizike e shpirtërore, për shkak të daljes nga rrethi i porosive të Kuranit të Shenjtë. Kjo temë përmendet edhe në ajetin vijues që, bukuria në të vërtetë është bukuri e *takvasë* dhe se në xhami nuk do të merrni dot asnjë bukuri shpirtërore, nëse do të hyjni në të pa bukurinë tuaj, pra, pa *takvanë* tuaj.

Kjo sure flet edhe për statusin e lartë të Profetit Muhammed<sup>savs</sup> që nuk i është dhënë ndonjë profeti tjetër. Domethënë, ai dhe sahabët e tij do të kenë njohuri kaq të larta për xhenetin, sa që përmes tyre, Ditën e Gjykimit, ata do të arrijnë të njohin çdo

shpirt nëse i përket xhenetit apo xhehenemit.

Pas kësaj, përmenden Profetë të ndryshëm, të cilët u ishin dërguar popujve të tyre dhe që dhanë sakrifica nga më të mëdhatë për t'ua siguruar udhëzimin. Gjithashtu, ishte Profeti Muhammed<sup>savs</sup> që e siguroi këtë udhëzim më fuqishëm se të gjithë Profetët e tjerë.

Më pas thuhet edhe më qartësisht që edhe Profetët e mëparshëm ishin në pozita të larta shpirtërore, megjithatë, fuqia bekuuese e tyre ishte e kufizuar dhe se përpara Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, askush tjetër nuk kishte ardhur me udhëzim universal. Kështu, Profeti Muhammed<sup>savs</sup> u zgjodh në krye të të gjithë Profetëve, sepse ai ishte mëshirë për tërë botën, domethënë, edhe për Lindjen, edhe për Perëndimin; edhe për arabët, edhe për joarabët, edhe për njerëzit, edhe për kafshët. Kjo është diçka që vërtetohet nga shumë hadithe.

[Në ajetin nr. 188, përmendet Ora]. Një kiamet që do të bëhej përmes Profetit Muhammed<sup>savs</sup> gjatë jetës së tij, është ai që përmendet në ajetin:

*“U afrua Ora dhe u ça hëna”* (54:2)

Kiameti i dytë do të ishte ai që do të bëhej në epokën e të mëvonshmëve (*ahirinëve*), kur do të ringjallehin të vdekurit për herë të dytë, sepse ishin ringjallur një herë në epokën e të parëve. Do të jetë edhe një kiamet tjetër i cili do t'u binte njerëzve më të këqij (*eshrarun-nas*). Të gjitha këto kiamete kanë lidhje të ngushtë me ardhjen e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. *Elif.Lam.Mim.Sad.* (Unë jam Allahu, më i Dijshmi, i Drejti në fjalë.)<sup>1</sup>

الْمَصِّ ②

3. Një Libër të është zbritur ty; le të mos ketë asnjë ngushtësi në gjoksin tënd ndaj tij; që të alarmosh përmes tij; dhe është këshillë për besimtarët.

كُتِبَ أَنْزَلَ إِلَيْكَ فَلَا يَكُنْ فِي  
صَدْرِكَ حَرَجٌ مِّنْهُ لِتُنذِرَ بِهِ وَذِكْرَى  
لِلْمُؤْمِنِينَ ③

4. Ndiqeni atë që ju është zbritur prej Zotit tuaj dhe mos ndiqni mbrojtës të tjerë përveç Tij. Pak e pranoni këshillën.

اتَّبِعُوا مَا أَنْزَلَ إِلَيْكُم مِّن رَّبِّكُمْ وَلَا  
تَتَّبِعُوا مِنْ دُونِهِ أَوْلِيَاءَ قَلِيلًا مَّا  
تَذَكَّرُونَ ④

5. Dhe sa shumë vendbanime i kemi shkatërruar! Atyre u erdhi ndëshkimi Ynë gjatë natës (kur ata ishin në gjumë) ose në mesditë kur ata pushonin.

وَكَمْ مِّن قَرْيَةٍ أَهْلَكْنَاهَا فَبَاءَهَا بَأْسَنَا  
بَيَاتًا أَوْ هُمْ قَائِلُونَ ⑤

6. E kur u erdhi ndëshkimi Ynë, ata nuk kanë pasur tjetër thirrje veçse të thoshin: “Ne kemi qenë të padrejtë!”<sup>2</sup>

فَمَا كَانَ دَعْوَاهُمْ إِذْ جَاءَهُمْ بَأْسُنَا إِلَّا  
أَنْ قَالُوا إِنَّا كُنَّا ظَالِمِينَ ⑥

1. Sipas Ibni Abbasit, shkurtesat (shkronjat) *Elif.Lam.Mim.* nënkuptojnë “Unë jam Allahu, më i Dijshmi (Tefsiri i Bagaviut 2:1), kurse shkronja *Sad* nënkupton “Unë shpjegoj” (arab. *ufassilu*) (Tefsiri i Taberiut 7:1). Përmbajtja e kësaj sureje e justifikon këtë interpretim, sepse Surja jo vetëm shpalos dijen Hyjnore, por shpjegon gjerësisht dhe me drejtësi temën e trajtuar në suren e mëparshme. Kështu që, shkronja *sad* në këto shkurtesa, ndër të tjera, përfaqëson atributet e Zotit “*Sadik*” (i drejti në fjalë) dhe “*ufassilu*” (shpjegoj me hollësi). Për më shumë rreth shkurtesave të Kuranit, lexoni 2:2.

2. Arsyeja pse edhe ateistët më të përbetuar nganjëherë kur i zë fatqësia e thërrasin Zotin për ndihmë, është se në një kohë kaq të tmerrshme njeriu jo vetëm që kupton pafuqinë e tij, por kupton edhe Plotfuqinë e Qenies Supreme, besimi në të cilin është gdhendur në natyrën e njeriut. Lexoni edhe 7:173.

7. Kështu që, Ne patjetër do t'u kërkojmë llogari atyre që u janë dërguar të Dërguarit dhe Ne patjetër do t'u kërkojmë llogari edhe të Dërguarve.

8. Ne do t'ua rrëfejmë me dije dhe Ne nuk kemi munguar.

9. Peshimi i vërtetë do të jetë atë ditë, (dhe do të jetë) me drejtësi. Pra, ata, që do t'u rëndojë peshorja, do të jenë të suksesshëm.

10. Dhe ata, që do t'u mbetet e lehtë peshorja, do t'i kenë shkaktuar humbje vetvetes, për shkak se bënë padrejtësi ndaj ajeteve Tona.

11. Sigurisht, Ne ju kemi dhënë forcë në tokë dhe në të ju kemi mundësuar mjetet e jetesës. Pak falënderoni ju.

12. Sigurisht, Ne ju kemi krijuar, pastaj ju dhamë formën, pastaj u thamë engjëjve: “Bëni sexhde për Ademin!” Ata e bënë sexhden, përveç Iblisit; ai nuk u bë nga ata që bëjnë sexhde.<sup>3</sup>

13. (Zoti) tha: “Çfarë të ndaloi ty që nuk e bëre sexhden, kur Unë të kam urdhëruar?” Ai tha: “Jam më i mirë

فَلَنَسْأَلَنَّ الَّذِينَ أُرْسِلَ إِلَيْهِمْ وَلَنَسْأَلَنَّ  
الْمُرْسَلِينَ ﴿٧﴾

فَلَنَقُصَّنَّ عَلَيْهِمْ بِعِلْمِهِ وَمَا كُنَّا غَائِبِينَ ﴿٨﴾

وَالْوَزْنَ يَوْمَئِذٍ الْحَقُّ فَمَنْ تَقَلَّتْ  
مَوَازِينُهُ فَأُولَئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ ﴿٩﴾

وَمَنْ خَفَّتْ مَوَازِينُهُ فَأُولَئِكَ الَّذِينَ  
خَسِرُوا أَنفُسَهُمْ بِمَا كَانُوا بِآيَاتِنَا  
يَظْلِمُونَ ﴿١٠﴾

وَلَقَدْ مَكَّنَّاكُمْ فِي الْأَرْضِ وَجَعَلْنَا لَكُمْ  
فِيهَا مَعَايِشَ قَلِيلًا مَا تَشْكُرُونَ ﴿١١﴾

وَلَقَدْ خَلَقْنَاكُمْ ثُمَّ صَوَّرْنَاكُمْ ثُمَّ قُلْنَا  
لِلْمَلَائِكَةِ اسْجُدُوا لِآدَمَ فَسَجَدُوا إِلَّا  
إِبْلِيسَ لَمْ يَكُنْ مِنَ السَّاجِدِينَ ﴿١٢﴾

قَالَ مَا مَنَعَكَ آلَا تَسْجُدَ إِذْ أَمَرْتُكَ قَالَ  
أَنَا خَيْرٌ مِنْهُ خَلَقْتَنِي مِنْ نَارٍ وَخَلَقْتَهُ

3. Sikurse ajeti 2:31 që pohon se Ademi u krijua në Tokë e jo diku tjetër, si dhe ai qe kalif (pasardhës), pra jo njeriu i parë në Tokë, ky ajet gjithashtu e mbështet edhe më shumë të njëjtin përfundim. Duke iu drejtuar njerëzve, thotë: Sigurisht, Ne ju kemi krijuar, pastaj ju dhamë formën, pastaj u thamë engjëjve: “Bëni sexhde për Ademin!” Përemri shumë “ju”, tregon se Zoti së pari krijoi njerëzit, u dha formën e duhur që deshi, e pastaj e caktoi Ademin si Kalif a Profet. Prandaj, është e gabuar të konkludohet se njerëzimi filloi me Ademin<sup>as</sup> që jetoi pak më shumë se 6000 vjet më parë dhe se racat e ndryshme që jetojnë tani në këtë tokë janë të gjitha medoemos pasardhës i tij. Lexoni 2:31; 38:74 dhe parathënien e sures 76.

se ai; mua më ke krijuar prej zjarrit, kurse atë e krijoje prej baltës.”

مِنْ طِينٍ ۝١٦

14. (Zoti) tha: “Dil nga këtu. Nuk mund të tregohesh mendjemadh në të, andaj dil se je ndër të poshtrit.”<sup>4</sup>

قَالَ فَاهْبِطْ مِنْهَا فَمَا يَكُونُ لَكَ أَنْ تَتَكَبَّرَ فِيهَا فَاخْرُجْ إِنَّكَ مِنَ الصَّغِيرِينَ ۝١٤

15. Ai tha: “Më jep afat deri në ditën kur ata do të ringjallen.”

قَالَ أَنْظِرْنِي إِلَى يَوْمِ يُبْعَثُونَ ۝١٥

16. Ai tha: “Të jepet afati.”

قَالَ إِنَّكَ مِنَ الْمُنظَرِينَ ۝١٦

17. Ai tha: “Ngaqë më ke cilësuar të devijuar tashmë, do t'i pres ata në rrugën Tënde të drejtë.”<sup>5</sup>

قَالَ فِيمَا آغْوَيْتَنِي لَأَقْعُدَنَّ لَهُمْ صِرَاطَكَ الْمُسْتَقِيمَ ۝١٧

18. Më pas do t'u vij edhe nga para, edhe nga mbrapa, edhe nga e djathta, edhe nga e majta, dhe Ti shumicën e tyre nuk do t'i gjesh mirënjohës.”

ثُمَّ لَا يَأْتِيهِمْ مِنْ بَيْنِ أَيْدِيهِمْ وَمِنْ خَلْفِهِمْ وَعَنْ أَيْمَانِهِمْ وَعَنْ شَمَائِلِهِمْ وَلَا تَجِدُ أَكْثَرَهُمْ شَاكِرِينَ ۝١٨

4. Mendjemadhësia vjen prej djallit, ajo edhe njeriun e bën djall. Për sa kohë që njeriu nuk e largon mendjemadhësinë, ajo i mbetet pengesë në rrugën e pranimit të së Vërtetës dhe të marrjes së bekimeve Hyjnore. Andaj, nuk duhet të tregohemi mendjemëdhën timer asnjë formë, as për dijen e as për pasurinë, as për bukurinë e as për fisin a grupin që i përkasim. Në përgjithësi, për këto gjëra njeriu tregohet mendjemadh. Derisa njeriu nuk e pastron veten nga të gjitha format e mendjemadhësisë, ai nuk quhet i dëlirë te Zoti, dhe deri atëherë Zoti nuk i dhuron njohjen që mund t'ia djegë elementet negative të ndjenjave të tij, sepse në këtë gjendje, njeriu mbart një pjesë të djallit, që Zoti nuk e pëlqen. Djalli u tregua mendjemadh dhe tha – jam më i mirë se Ademi, sepse mua më krijoje prej zjarrit, kurse atë prej dheut (edhe në kuptimin figurativ, dheu simbolizon përlulësinë dhe përshtatjen në bazë të vullnetit të Zotit, kurse zjarri mendjemadhësinë dhe arrogancën). Rrjedhimisht, djalli u quajt i mallkuar dhe i përzënë. Kurse Ademi, edhe pse kishte gabuar, pati përlulësinë, rrjedhimisht mësoi diçka prej Zotit për ta korrigjuar gabimin (2:38). Atëherë Zoti e bëri të trashëgojë bekimet e Tij. Ademi e dinte se pa bekimin e Zotit asgjë nuk mund të arrinte dot, andaj u lut – “O Zoti ynë! Kemi shkelur veten tonë dhe nëse nuk do të na falësh e nuk do të na mëshirosh, me siguri do të bëhemi nga të humburit!” (7:24).

5. Edhe njerëzit që janë ndjekës të rrugës së drejtë, nuk janë të mbrojtur nga devijimi që u vjen nga djalli, nëse nuk kanë mbrojtjen e veçantë të Zotit të Madhërishëm. Ata që Kurani i Shenjtë i quajti si “ata që tërhoqën zemërim” dhe “të devijuar”, në fillim në rrugën e drejtë kanë qenë, por me kalimin e kohës, devijuan.



19. (Zoti) tha: “Dil prej këtu i poshtëruar dhe i përzënë! Kushdo që do të të ndjekë prej tyre, Unë do ta mbush xhehenemin me ju të gjithë.”

20. “O Adem! Ti dhe gruaja jote qëndro në xhenet. Ju të dy hani nga të doni, por mos iu afroni kësaj peme, sepse do të bëheni ndër të padrejtët.”<sup>6</sup>

21. Djalli i cyti ata të dy, që atyre t’u zbulonte disa nga të turpshmet e tyre që ishin të fshehta për ta. Ai tha: “Zoti juaj ju ka ndaluar nga kjo pemë vetëm që të mos bëheni engjëj ose të përjetshëm.”<sup>7</sup>

22. Dhe ai u bëri be: “Unë vërtet jam këshillues juaji”.

23. Kështu, ai i shtyu me mashtrim. E kur ata të dy e shijuan pemën, iu zbuluan të turpshmet e tyre dhe ata zunë t’i mbulonin me gjethet e xhenetit.<sup>8</sup> Zoti i tyre i thirri: “A nuk

قَالَ اٰخْرَجْ مِنْهَا مَذْمُوْرًا مَّدْحُوْرًا لَّمَنْ  
تَبِعَكَ مِنْهُمْ لَأَمْلَأَنَّ جَهَنَّمَ مِنْكُمْ  
اَجْمَعِيْنَ ۝

وَیَادْرُ اسْكُنْ اَنْتَ وَرَوْجُكَ الْجَنَّةَ فَكَلَّا  
مِنْ حَيْثُ شِئْتُمَا وَلَا تَقْرَبَا هَذِهِ الشَّجَرَةَ  
فَتَكُوْنَا مِنَ الظَّالِمِيْنَ ۝

فَوَسَّوَسَ لَهَا الشَّيْطٰنُ لِيُبْدِيَ لَهَا مَا وَّرٰى  
عَنْهَا مِنْ سَوَاتِهَا وَقَالَ مَا نَهَاكُمَا  
رَبُّكُمَا عَنْ هَذِهِ الشَّجَرَةِ اِلَّا اَنْ تَكُوْنَا  
مَلَکِيْنَ اَوْ تَكُوْنَا مِنَ الْخٰلِدِيْنَ ۝

وَ قَا سَمَهَا اِنِّي لَكُمْ اَلِمِّنَ التَّصْحِيْحِيْنَ ۝

فَدَلَّهَا بِعُرُوْرٍ ۚ فَلَمَّا ذَاقَا الشَّجَرَةَ بَدَتْ  
لَهُمَا سَوَاتِهِمَا وَطَفِقَا يَخْصِفْنَ عَلَيْهِمَا مِنْ  
وَّرَقِ الْجَنَّةِ ۗ وَنَادَيْتُهُمَا رَبُّهُمَا اَلَمْ

6. Lexoni 2:36.

7. Mendimet e këqija jo vetëm që e çojnë njeriun drejt rrënimit, por edhe i shfaqin dobësitë e tij. Meqenëse vendi ku u vendos të banonte Ademi është përshkruar në Kuran në kuptimin figurativ si një “kopsht”, metafora vijon edhe në përshkrimin e mëtejshëm. Zoti e ndalon t’i afrohet një peme të caktuar, e cila nuk ishte një pemë në kuptimin fizik, por ndalimet që Zoti i kishte shpallur atij, gjërat që do ta dëmtonin “kopshtin” e tij. Për shpjegimin e pemës lexoni 2:36.

8. Çfarë janë gjethet e xhenetit? Kur njeriu e konsumon mëkatin, ndërgjegjja e tij e qorton dhe i thotë – Shiko sa i dobët që je! – Kjo punë nuk të solli asnjë të mirë! – Po të mos e kishe bërë këtë, nuk do të humbisje asnjë gjë! Atëherë njeriu ndërgjegjësohet dhe fillon të grumbullojë gjethet e xhenetit, pra veprat e mira, të cilat ia mposhtin të metat dhe që e shpini përsëri drejt xhenetit. Shkurt, njeriu fillon t’i mposhtë dobësitë e tij dhe pendohet për mëkatet që ka bërë. Kurani flet për gjethet e xhenetit (arab. varakul-xheneh), dhe varak në arabisht ka edhe kuptimin e bukurisë. Pra, shëmtia që shkaktohet nga një veprim jo i mirë, mund të

ju kisha ndaluar ju të dy nga kjo pemë dhe a nuk ju kisha thënë se djalli përnjëmend është armiku juaj i hapët?!”<sup>9</sup>

أَنهَكُمَا عَنْ تِلْكَ الشَّجَرَةِ وَأَقُل لَّكُمَا  
إِنَّ الشَّيْطَانَ لَكُمْ عَدُوٌّ مُّبِينٌ ﴿٢٦﴾

24. Ata të dy thanë: “O Zoti ynë! Kemi shkëlur veten tonë dhe nëse nuk do të na falësh e nuk do të na mëshirosh, me siguri do të bëhemi nga të humburit!”<sup>10</sup>

قَالَا رَبَّنَا ظَلَمْنَا أَنفُسَنَا وَإِن لَّمْ  
تَعْفِرْ لَنَا وَتَرْحَمْنَا لَنَكُونَنَّ مِنَ الْخَاسِرِينَ ﴿٢٧﴾

25. Ai tha: “Dilni ju të gjithë (nga këtu). Disa prej jush janë armiq të disave të tjerë. Në tokë do të keni qëndrim dhe mjete për një kohë të caktuar.”

قَالَ اهْبِطُوا بَعْضُكُمْ لِبَعْضٍ عَدُوٌّ وَلَكُمْ  
فِي الْأَرْضِ مُسْتَقَرٌّ وَمَتَاعٌ إِلَىٰ حِينٍ ﴿٢٨﴾

26. Tha: “Në të do të jetoni, në të do të vdisni dhe prej saj do të nxirreni.”

قَالَ فِيهَا تَحْيَوْنَ وَفِيهَا تَمُوتُونَ وَمِمَّا  
تُخْرَجُونَ ﴿٢٩﴾

zëvendësohet vetëm me bukurinë, të cilën e sjellin pendesa dhe vepra e mirë. Për më shumë rreth veshjes që ia zbukuron shpirtin besimtarit, lexoni edhe 7:27.

9. Çdo njeri ka disa dobësi të cilat, nganjëherë as ai nuk i njeh, por që ekspozohen në momentin e sprovës apo të tundimit. Kështu, kur Ademi u mashtrua nga djalli, ai u bë i vetëdijshëm për disa nga dobësitë e tij. Kurani nuk thotë se dobësitë e Ademit dhe gruas së tij u bënë të njohura edhe për njerëzit e tjerë, por se ata u bënë të vetëdijshëm për to dhe më pas i kërkuan falje dhe fuqi Zotit. Në një moment të tillë, çdo njeri që i përngjan Ademit e kupton faktin që pohon ky ajet – djalli përnjëmend është armiku i hapët! Këtu vlen të shpjgohet edhe një element tjetër. Zoti i Madhërishëm i ka lënë njeriut dy thirrës për ta sprovuar atë: njëri që e thërret drejt mirësisë e që quhet Shpirt i shenjtë, dhe tjetri që e thërret drejt ligësisë e që quhet djall (*shejtani*) ose *iblis*. Që të dy këta thirrës vetëm e ftojnë njeriun drejt mirësisë apo ligësisë, por nuk e detyrojnë për asgjë. Njeriu duhet të logjikojë e të udhëzohet në vendimmarrjen e tij për ta bërë hapin, sipas aftësive që i ka dhënë Zoti, siç thuhet në një ajet tjetër “Zoti i shpalli (njeriut) edhe ligësinë, edhe mirësinë.” (91:9).

10. Shumë njerëz ankohen ndaj Zotit, ndërkohë që veten dhe veprat e tyre nuk i vënë re. Janë pikërisht padrejtësitë e vetë njeriut që e dëmtojnë atë, kurse Allahu është shumë Mëshirëbërës dhe shumë Bujar. Ka disa që e ndiejnë mëkatit e tyre, por ka edhe të tillë që as nuk e ndiejnë fare. Për këtë arsye, Allahu i Madhërishëm na mëson që gjithmonë t'i kërkojmë falje Atij. Ky quhet *istigfar*. Pra, njeriu vazhdimisht duhet t'i kërkojë falje Allahut për çdo mëkat, qoftë të hapur, qoftë të fshehur, qoftë për atë që di, qoftë për atë që nuk e di. Po kështu, t'i kërkojë falje Zotit për mëkatet që bën qoftë përmes duarve, këmbëve, gjuhës, hundës, syve apo veshëve.

27. O bijtë e Ademit! Ne ju kemi zbritur veshje, që mbulon të turpshmet tuaja dhe është (edhe) për zbukurim. Dhe veshja e druajtjes (ndaj Zotit), ajo është më e mira! Këto janë disa nga shenjat e Allahut, që ju të mendoheni.<sup>11</sup>

يَبْنِيٰ اٰدَمَ قَدْ اَنْزَلْنَا عَلَيْكُمْ لِبَاسًا يُوَارِي  
سَوَاتِكُمْ وَّرِيْشًا وَّ لِبَاسًا لِّتَمُوْا ۗ ذٰلِكَ  
خَيْرٌ ۗ ذٰلِكَ مِنْ اٰتِ اللّٰهِ لَعَلَّهُمْ  
يَذْكُرُوْنَ ﴿٧٧﴾

28. O bijtë e Ademit! Kurrsesi të mos ju trazojë djalli siç i ka dëbuar prindërit tuaj prej xhenetit; ai ua rrëmbeu veshjet, që t'ua zbulojë të turpshmet e tyre; ai dhe klani i tij ju shohin nga atje, ku ju nuk i shihni dot. Sigurisht, Ne i kemi bërë dajtë miq të atyre që nuk besojnë.

يَبْنِيٰ اٰدَمَ لَا يَفْتِنَنَّكُمُ الشَّيْطٰنُ كَمَا  
اَخْرَجَ اٰبَوَيْكُمْ مِّنَ الْجَنَّةِ يَنْزِعُ عَنْهُمَا  
لِبَاسَهُمَا لِيُرِيَهُمَا سَوَاتِهِمَا ۗ اِنَّهٗ يَرٰكُمْ  
هُوَ وَّقَبِيْلُهُ مِنْ حَيْثُ لَا تَرَوْنَهُمْ ۗ اِنَّا  
جَعَلْنَا الشَّيْطٰنَ اَوْلِيَّاءَ لِلَّذِيْنَ لَا  
يُؤْمِنُوْنَ ﴿٧٨﴾

29. E kur bëjnë paturpësi, thonë: “Kemi parë etërit tanë (duke bërë) kështu dhe Allahu na e ka urdhëruar këtë.” Thuaju: Pa dyshim, Allahu nuk urdhëron paturpësinë. A thoni për Allahun atë që nuk e dini?!

وَ اِذَا فَعَلُوْا فَاحِشَةً قَالُوْا وَجَدْنَا عَلَيْهَا  
اٰبَاءَنَا وَّ اللّٰهُ اَمْرًا بِهَا ۗ قُلْ اِنَّ اللّٰهَ لَا  
يَاْمُرُ بِالْفَحِشٰٓءِ ۗ اَنْتَقُوْنَ عَلٰى اللّٰهِ مَا لَا  
تَعْلَمُوْنَ ﴿٧٩﴾

30. Thuaju: Zoti im ka urdhëruar drejtësinë; në çdo xhami të drejtoni vëmendjen tuaj dhe t'i luteni Atij, duke ia përkushtuar besimin vetëm Atij. Siç ju ka krijuar Ai për herë të parë, (pas vdekjes) ashtu do të ktheheni.

قُلْ اَمَرَ رَبِّيْ بِالْقِسْطِ ۗ وَّ اَقِيْمُوا وُجُوْهَكُمْ  
عِنْدَ كُلِّ مَسْجِدٍ وَّ ادْعُوْهُ مُخْلِصِيْنَ لَهُ  
الدِّيْنَ ۗ كَمَا بَدَاكُمْ تَعُوْدُوْنَ ﴿٨٠﴾

11. Në këtë ajet, Zoti i Madhërisëm druajtjen ndaj Tij (arab. *takva*) e quajti *veshje*. Kjo tregon se pikërisht druajtja ndaj Zotit është ajo që i sjell njeriut mbrojtjen dhe bukurinë shpirtërore. Dhe druajtja ndaj Tij është që njeriu të kujdeset për të gjitha përgjegjësitë dhe zotimet e tij që ai ka qoftë karshi Zotit, qoftë karshi njerëzve, dhe sa të ketë mundësi, të ndjekë rrugën e së vërtetës deri në hollësi. Për druajtjen ndaj Zotit, lexoni edhe 2:3; 7:23.

31. Një grup Ai e udhëzoi, kurse grupi tjetër e meritoi humbjen. Vërtet, ata i morën djajtë për miq, duke e lënë Allahun, dhe mendojnë se janë të udhëzuar.

32. O bijtë e Ademit! Merrni bukurinë tuaj (pra, veshjen e druajtjes ndaj Zotit) në çdo xhami. Hani e pini dhe mos e teproni. Sigurisht, Ai nuk i do tepruesit.<sup>12</sup>

33. Pyeti: Kush e ndaloi bukurinë e Allahut, që Ai ka nxjerrë për robërit e Tij, si dhe ushqimet e pastra?! Thuaju: Në këtë botë, këto janë për ata që besuan (dhe) Ditën e Kiametit (pra, në Ditën e Gjykimit) do të jenë veçanërisht për ta. Kështu Ne i shpjegojmë ajetet Tona për njerëzit që dinë.

34. Thuaju: Zoti im ka ndaluar vetëm paturpësitë, edhe të dukshmet, edhe

فَرِيقًا هَدَىٰ وَفَرِيقًا حَقَّ عَلَيْهِمُ الضَّلَالَةُ ۗ  
إِنَّهُمْ اتَّخَذُوا الشَّيَاطِينَ أَوْلِيَاءَ مِنْ دُونِ  
اللَّهِ وَيَحْسَبُونَ أَنََّّهُمْ مُهْتَدُونَ ﴿٣١﴾

يَبْنِي آدَمَ خُذُوا زِينَتَكُمْ عِنْدَ كُلِّ مَسْجِدٍ  
وَكُلُوا وَاشْرَبُوا وَلَا تُسْرِفُوا ۚ إِنَّهُ لَا يُحِبُّ  
الْمُسْرِفِينَ ﴿٣٢﴾

قُلْ مَنْ حَرَّمَ زِينَةَ اللَّهِ الَّتِي أَخْرَجَ  
لِعِبَادِهِ وَالطَّيِّبَاتِ مِنَ الرِّزْقِ قُلْ هِيَ  
لِلَّذِينَ آمَنُوا فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا خَالِصَةً  
يَوْمَ الْقِيَامَةِ ۗ كَذَلِكَ نَفْصَلُ الْآيَاتِ لِقَوْمٍ  
يَعْلَمُونَ ﴿٣٣﴾

قُلْ إِنَّمَا حَرَّمَ رَبِّي الْفَوَاحِشَ مَا ظَهَرَ  
مِنْهَا وَمَا بَطَّنَ ۖ وَالْإِثْمَ وَالْبَغْيَ بِغَيْرِ الْحَقِّ

12. Sipas Kuranit, gjendjet instinktive kanë ndikim shumë të thellë mbi gjendjet morale dhe ato shpirtërore, saqë te njeriu, edhe mënyra e të ushqyerit dhe e të pirit ndikojnë mbi gjendjet morale dhe shpirtërore të tij. Nëse ai i trajton gjendjet instinktive duke përfutur nga udhëzimet e Kuranit, po këto gjendje shndërrohen në morale dhe ndikojnë thellë mbi spiritualizmin e tij. Për këtë arsye, Kurani i jep rëndësi të veçantë pastërtisë, etikës dhe ekuilibrit trupor për kryerjen e të gjitha adhurimeve dhe për arritjen e pastërtisë së brendshme e të gjendjes së përlulësisë dhe të përvuajtjes te pragu i Zotit. Përvoja na dëshmon që edhe ushqime të ndryshme kanë ndikim në aftësitë mendore dhe shpirtërore të njeriut. Vërejmë se ata që kurrë nuk hanë mish, trimëria fillon t'u zbehet, derisa gradualisht e humbin guximin dhe bëhen shumë frikacakë, duke humbur kështu një dhunti të lavdishme që u ishte dhënë prej Zotit. Këtë dukuri mund ta gjejmë edhe në ligjin e natyrës, të vënë prej Zotit, ku asnjë nga kafshët barngrënëse nuk zotëron guximin që mund të ketë një kafshë mishngrënëse. Kështu që, nuk mund të dyshohet aspak që ushqimet kanë ndikim në moral. Nga ana tjetër, njerëzit që ditë e natë hanë vetëm mish dhe perimet i përdorin shumë pak në dietën e tyre, e humbin virtytin e butësisë e të përlulësisë. Kurse ata që ndjekin rrugën e mesme të të ushqyerit, i trashëgojnë të dyja llojet e virtyteve. Duke marrë parasysh pikërisht këtë urtësi, Kurani i Shenjtë thotë: Hani edhe mish edhe ushqime të tjera, por me asgjë mos e teproni, që mos t'ju ndikojë për keq në gjendjen morale dhe as mos t'i sjellë dëm shëndetit tuaj. Lexoni edhe 5:4; 23:52.

të fshehtat; mëkatin dhe rebelimin pa të drejtë dhe t'i sajoni Allahut ortak, për të cilin Ai nuk ka zbritur argument, dhe të thoni për Allahun diçka që nuk e dini.

35. Për çdo popull ka një afat. Kur vjen afati i tyre, ata nuk mund të kthehen mbrapa për asnjë çast, e as nuk mund të tejkalojnë.

36. O bijtë e Ademit! Nëse vijnë të Dërguar nga gjiri juaj, që t'ju lexojnë ajetet e Mia, atëherë ata që druhen (nga Unë) dhe përmirësojnë veten, nuk do të kenë as frikë, e as nuk do të pikëllohen.<sup>13</sup>

37. Ata që i quajtën gënjeshtër ajetet Tona dhe u treguan mendjemëdhenj ndaj tyre, janë banorë të zjarrit. Në të do të jetojnë për një kohë të gjatë.

38. Kush mund të jetë më keqbërës sesa ai që shpif gënjeshtër mbi Allahun ose ai që i quan gënjeshtër ajetet e Tij?! Këta do t'i zërë fati i tyre sipas Librit. E kur t'u vijnë të dërguarit tanë për t'ua marrë shpirtin, do t'i pyesin: "Ku janë ata që u luteshit në vend të Allahut?" Ata do të thonë: "Na humbën!" Ata do të dëshmojnë kundër vetvetes që ishin mohues.

وَأَنْ تُشْرِكُوا بِاللَّهِ مَا لَمْ يُنَزَّلْ بِهِ  
سُلْطَانًا وَ أَنْ تَقُولُوا عَلَى اللَّهِ مَا لَا  
تَعْلَمُونَ ﴿٣٥﴾

وَلِكُلِّ أُمَّةٍ أَجَلٌ فَإِذَا جَاءَ أَجْلُهُمْ لَا  
يَسْتَخِرُونَ سَاعَةً وَلَا يَسْتَقْدِمُونَ ﴿٣٦﴾

يَبْنِي آدَمَ إِمَّا يَأْتِيَنَّكُمْ رُسُلٌ مِنْكُمْ يُقِصُونَ  
عَلَيْكُمْ آيَاتِي لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ فَلَا  
خَوْفَ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ ﴿٣٧﴾

وَالَّذِينَ كَذَّبُوا بِآيَاتِنَا وَاسْتَكْبَرُوا عَنْهَا  
أُولَئِكَ أَصْحَابُ النَّارِ هُمْ فِيهَا خَالِدُونَ ﴿٣٨﴾

فَمَنْ أَظْلَمُ مِمَّنِ افْتَرَى عَلَى اللَّهِ كَذِبًا  
أَوْ كَذَّبَ بِآيَاتِهِ ۗ أُولَئِكَ يَأْتُهُمُ نَصِيبُهُمْ  
مِّنَ الْكِتَابِ ۗ حَتَّىٰ إِذَا جَاءَهُمْ رَسُولُنَا  
يَنفُوقُوهُمْ ۗ قَالُوا آيِنَ مَا كُنْتُمْ تَدْعُونَ  
مِن دُونِ اللَّهِ ۗ قَالُوا ضَلُّوا عَنَّا وَشَهِدُوا  
عَلَىٰ أَنفُسِهِمْ أَنَّهُمْ كَانُوا كَافِرِينَ ﴿٣٩﴾

13. Njësoj si disa nga ajetet e mëparshme (7:27, 28, dhe 32), edhe ky ajet u drejtohet njerëzimit me fjalët "O bijtë e Ademit" dhe mesazhi është jo vetëm për gjeneratën e kohës së Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, por për të gjitha gjeneratat e ardhshme.

39. (Atëherë) Ai do t'u thotë: Si popujt që ishin para jush nga xhindët dhe njerëzit, hyni edhe ju në zjarr! Sa herë që një popull do të hyjë në të, do të mallkojë të singjashmin e vet. Kur të gjithë do të grumbullohen aty, i mëvonshmi i tyre do të shprehë për të parin: "O Zoti ynë! Këta janë që na devijuan, andaj, ndëshkimin e zjarrit jepua dyfish!" Ai do t'i thotë: "I dyfishtë është për çdokënd, por ju nuk e dini."

40. Dhe i pari i tyre do t'i thotë të mëvonshmit: "Nuk keni ndonjë epërsi mbi ne, andaj, shijojeni ndëshkimin për atë që keni punuar."

41. Pa dyshim, ata që i quajtën gënjeshtër ajetet Tona dhe u treguan mendjemëdhenj ndaj tyre, nuk do t'u hapen portat e qiellit dhe ata nuk do të hyjnë në xhenet, derisa deveja të futet në vrimë të gjilpërës. Ne kështu i dënojmë fajtorët.

42. Ata do të kenë një shtrat prej xhehenemit dhe sipër tyre mbulesa (ndëshkuese). Ne kështu i dënojmë të padrejtët.

43. Dhe ata që besuan dhe bënë të mira, nuk do të ngarkojmë askënd prej tyre përtej kapacitetit të tij. Këta janë banorë të xhenetit. Në të do të jetojnë përgjithmonë.

44. Ne do t'ua heqim meritë nga kraharorët e tyre; nën sundimin e tyre do të rrjedhin lumenj. Ata do

قَالَ ادْخُلُوا فِي أُمَمٍ قَدْ خَلَتْ مِنْ قَبْلِكُمْ  
مِنَ الْجِنِّ وَالْإِنْسِ فِي النَّارِ كُلَّمَا دَخَلَتْ  
أُمَّةٌ لَعَنَتْ أُخْتَهَا حَتَّى إِذَا آذَرْتُمُوهَا فِيهَا  
جَمِيعًا قَالَتْ أُخْرَبُهُمْ لِأَوْلِهِمْ رَبَّنَا  
هَؤُلَاءِ أَصْلُونَا فَاتِهِمْ عَذَابًا ضِعْفًا مِّنَ  
النَّارِ قَالَ لِكُلِّ ضِعْفٌ وَلَكِنْ لَا  
تَعْلَمُونَ ﴿٣٩﴾

وَقَالَتْ أَوْلَاهُم لِأُخْرَبُهُمْ فَمَا كَانَ  
لَكُمْ عَلَيْنَا مِنْ فَضْلٍ فذُوقُوا الْعَذَابَ بِمَا  
كُنتُمْ تَكْسِبُونَ ﴿٤٠﴾

إِنَّ الَّذِينَ كَذَّبُوا بِآيَاتِنَا وَاسْتَكْبَرُوا عَنْهَا  
لَا تُفْتَحُ لَهُمْ أَبْوَابُ السَّمَاءِ وَلَا يَدْخُلُونَ  
الْجَنَّةَ حَتَّى يُلَاجِ الْجَمَلُ فِي سَمِّ الْخِيَاطِ  
وَكَذَلِكَ نَجْزِي الْمُجْرِمِينَ ﴿٤١﴾

لَهُمْ مِنْ جَهَنَّمَ مِهَادٌ وَمِنْ فَوْقِهِمْ  
غَوَاشٍ وَكَذَلِكَ نَجْزِي الظَّالِمِينَ ﴿٤٢﴾

وَالَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَا نُكَلِّفُ  
نَفْسًا إِلَّا وُسْعَهَا أُولَئِكَ أَصْحَابُ الْجَنَّةِ  
هُمْ فِيهَا خَالِدُونَ ﴿٤٣﴾

وَنَرَعْنَا مَا فِي صُدُورِهِمْ مِنْ غَلٍّ نَجْزِي  
مِنْ تَحْتِهِمُ الْأَنْهَارَ وَقَالُوا الْحَمْدُ لِلَّهِ

të thonë: “Lavdia është e Allahut që na udhëzoi për këtë, ne vetë nuk do ta gjenim udhën, në qoftë se Allahu nuk do të na udhëzonte; pa dyshim, (neve na) erdhën të Dërguarit e Zotit tonë me të vërtetën.” Dhe ata do të njoftohen me zë: “Ky është xheneti që e trashëguat për atë që keni punuar!”

45. Banorët e xhenetit do t'i thërrasin ata të zjarrit: “Ne e gjetëm të vërtetë atë që Zoti ynë na premtoi. A e gjetët edhe ju të vërtetë atë që Zoti juaj ju premtoi?” Ata do të thonë: “Po.” Atëherë, një njoftues do të njoftojë mes tyre: Mallkimi i Allahut qoftë mbi keqbërësit,

46. të cilët pengojnë nga rruga e Allahut dhe tentojnë shtrembësi në të. Pikërisht këta e mohojnë *ahiretin*.

47. Midis tyre do të ketë një perde. Në lartësi do të ketë burra që njohin çdokënd nga shenjat e tij. Ata do t'i thërrasin banorët e xhenetit: “Paqja qoftë mbi ju!”, (e këta të fundit) pa hyrë ende në të, do ta shpresojnë (xhenetin).

48. E kur shikimi i tyre do t'u drejtohet banorëve të zjarrit, thonë: “O Zoti ynë! Mos na bëj nga njerëzit keqbërës!”

49. Banorët e lartësive do të thërrasin (ca) burra, që i njohin nga shenjat e tyre, dhe do t'u thonë: “Nuk ju vlejten as klani e as mendjemadhësia juaj!

الَّذِي هَدَيْنَا لِهَذَا وَمَا كُنَّا لِنَهْتَدِيَ لَوْلَا أَنْ هَدَيْنَا اللَّهُ لَقَدْ جَاءَتْ رَسُولَنَا بِالْحَقِّ وَتُودُّوْا أَنْ تَكْفُرُوا بِالْحَقِّ أَوْ يُرْمَوْهَا بِمَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ ﴿٤٥﴾

وَنَادَى أَصْحَابُ الْجَنَّةِ أَصْحَابَ النَّارِ أَنْ قَدْ وَجَدْنَا مَا وَعَدَنَا رَبُّنَا حَقًّا فَهَلْ وَجَدْتُمْ مَا وَعَدَ رَبُّكُمْ حَقًّا قَالُوا نَعَمْ فَأَذَّنَ مُؤَذِّنٌ بَيْنَهُمْ أَنْ لَعْنَةُ اللَّهِ عَلَى الظَّالِمِينَ ﴿٤٦﴾

الَّذِينَ يَصُدُّونَ عَنْ سَبِيلِ اللَّهِ وَيَبْغُونَهَا عِوَجًا وَهُمْ بِالْآخِرَةِ كَفِرُونَ ﴿٤٧﴾

وَبَيْنَهُمَا حِجَابٌ وَعَلَى الْأَعْرَافِ رِجَالٌ يَعْرِفُونَ كُلًّا بِسِيمَاهُمْ وَنَادَوْا أَصْحَابَ الْجَنَّةِ أَنْ سَلِّمُوا عَلَيْكُمْ لَمْ يَدْخُلُوهَا وَهُمْ يَطْمَعُونَ ﴿٤٨﴾

وَإِذَا صُرِفَتْ أَبْصَارُهُمْ تِلْقَاءَ أَصْحَابِ النَّارِ قَالُوا رَبَّنَا لَا تَجْعَلْنَا مَعَ الْقَوْمِ الظَّالِمِينَ ﴿٤٩﴾

وَنَادَى أَصْحَابُ الْأَعْرَافِ رِجَالًا لَا يَعْرِفُونَهُمْ بِسِيمَاهُمْ قَالُوا مَا أَغْنَىٰ عَنْكُمْ جَمْعُكُمْ وَمَا كُنْتُمْ تَسْتَكْبِرُونَ ﴿٥٠﴾

50. A këta janë ata për të cilët betoheshit se Allahu nuk do të ketë mëshirë ndaj tyre?!” (O besimtarë!) Hyni në xhenet! Nuk do të keni as frikë dhe as nuk do të pikëlloheni.

51. Dhe banorët e zjarrit do t'i thërrasin banorët e xhenetit: “Derdhni edhe mbi ne pak ujë ose atë që ju ka dhënë Allahu.” Ata do t'u përgjigjen: Sigurisht, Allahu i ka ndaluar të dyja këto për mohuesit,

52. (për ata) të cilët e morën besimin e tyre si dëfrim dhe lojë, dhe ata i mashtrroi jeta e kësaj bote. Andaj, sot edhe Ne do t'i harrojmë ata, ashtu siç ata e harruan takimin e kësaj dite të tyre dhe sepse ata i mohonin ajetet Tona.

53. Sigurisht, Ne u sollëm një Libër, që e shtjelluam mbi bazën e dijes (dhe që) ishte udhëzim dhe mëshirë për njerëzit që besojnë.

54. Vallë, veç interpretimin e tij po e presin ata?! Ditën kur do të vijë interpretimi i tij, ata që e kishin harruar këtë (Libër) deri më parë, do të thonë: “Të Dërguarit e Zotit tonë përnjëmend kishin ardhur me të vërtetën, andaj, a kemi ndërmjetësues, që të ndërmjetësojnë për ne, ose a mund të kthehemi që të veprojmë ndryshe nga ajo që kemi vepruar?” Sigurisht, ata vetveten e çuan në humbje dhe u iku gjithë ajo që trillonin.

أَهْوَلَاءِ الَّذِينَ أَقْسَمْتُمْ لَا يَنَالُهُمُ اللَّهُ بِرَحْمَةٍ ۖ اُدْخُلُوا الْجَنَّةَ لَا خَوْفَ عَلَيْكُمْ وَلَا أَنْتُمْ تَحْزَنُونَ ﴿٥٠﴾

وَنَادَى أَصْحَابُ النَّارِ أَصْحَابَ الْجَنَّةِ أَنْ أَفِضُوا عَلَيْنَا مِنَ الْمَاءِ أَوْ مِمَّا رَزَقَكُمُ اللَّهُ قَالُوا إِنَّ اللَّهَ حَرَمَهَا عَلَى الْكَافِرِينَ ﴿٥١﴾

الَّذِينَ اتَّخَذُوا دِينَهُمْ لَهْوًا وَ لَعِبًا وَ غَرَّبْتَهُمُ الْحَيَاةَ الدُّنْيَا قَالِيَوْمَ نُنَسِّهِمْ كَمَا نَسُوا لِقَاءَ يَوْمِهِمْ هَذَا وَمَا كَانُوا بِآيَاتِنَا يَجْحَدُونَ ﴿٥٢﴾

وَلَقَدْ جِئْنَاهُمْ بِكِتَابٍ فَصَّلْنَاهُ عَلَى عِلْمٍ هُدًى وَ رَحْمَةً لِّقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ ﴿٥٣﴾

هَلْ يَنْظُرُونَ إِلَّا تَأْوِيلَهُ ۖ يَوْمَ يَأْتِي تَأْوِيلَهُ يَقُولُ الَّذِينَ نَسُوهُ مِنْ قَبْلُ قَدْ جَاءَتْ رُسُلُ رَبِّنَا بِالْحَقِّ ۚ فَهَلْ لَنَا مِنْ شُفَعَاءَ فَيَشْفَعُوا لَنَا أَوْ نُرَدُّ فَنَعْمَلْ غَيْرَ الَّذِي كُنَّا نَعْمَلُ ۖ قَدْ خَسِرُوا أَنفُسَهُمْ ۖ وَ ضَلَّ عَنْهُمْ مَا كَانُوا يَفْتَرُونَ ﴿٥٤﴾



55. Pa dyshim, Zoti juaj, Allahu është Ai që krijoi qiejt dhe tokën në gjashtë ditë,<sup>14</sup> më pas u vendos në Arsh.<sup>15</sup> Ai e mbulon ditën me natën; (dita) e kërkon atë nxitimthi. (Ai krijoi) diellin, hënën dhe yjet, të nënshtuara me urdhrin e Tij. Dëgjoni! Atij i takon edhe krijimi, edhe sundimi. Zotëruesi i bekimeve është Allahu, Zoti i botëve.

إِنَّ رَبَّكُمُ اللَّهُ الَّذِي خَلَقَ السَّمَوَاتِ  
وَالْأَرْضَ فِي سِتَّةِ أَيَّامٍ ثُمَّ اسْتَوَىٰ عَلَى  
الْعَرْشِ ۗ يُعْشَىٰ لَيْلَ النَّهَارِ يَطْلُبُهُ  
حَثِيثًا ۗ وَ الشَّمْسُ وَالْقَمَرُ وَالنُّجُومُ  
مُسَخَّرَاتٌ بِأَمْرِهِ ۗ أَلَا لَهُ الْحَقُّ وَالْأَمْرُ ۗ  
تَبَارَكَ اللَّهُ رَبُّ الْعَالَمِينَ ﴿٥٥﴾

56. Lutjuni Zotit tuaj me përlulesi dhe fshehtësi. Sigurisht, Ai nuk i do ata që e teprojnë.

أَدْعُوا رَبَّكُمْ تَضَرُّعًا وَ خُفْيَةً ۗ إِنَّهُ لَا  
يُحِبُّ الْمُعْتَدِينَ ﴿٥٦﴾

57. Mos bëni çrregullime në tokë pas rregullimit të saj dhe lutjuni Atij me frikë dhe shpresë. Sigurisht, mëshira e Allahut është afër mirëbërësve.<sup>16</sup>

وَلَا تُفْسِدُوا فِي الْأَرْضِ بَعْدَ إِصْلَاحِهَا  
وَادْعُوهُ خَوْفًا وَ طَمَعًا ۗ إِنَّ رَحْمَتَ اللَّهِ  
قَرِيبٌ مِّنَ الْمُحْسِنِينَ ﴿٥٧﴾

14. Gjashtë ditë nënkuptojnë gjashtë periudha, ku një periudhë mund të përbëhet edhe nga miliona vjet.

15. Kurani i Shenjtë nga njëra anë tregon lidhjen e fortë që ka Krijuesi me krijesat, duke pohuar se Ai është Shkaku i të gjitha shkaqeve, Mbështetja e çdo gjëje dhe Shpirti i çdo shpirti dhe, nga ana tjetër, zbuloi se Ai qëndron mbi çdo krijim e përtej çdo dimensionit njerëzor, në mënyrë që askush të mos e keqkuptojë Atë si një qenie brenda llojit. Andaj, tha – Zoti qëndron në Arsh. Fjala arabe *arsh* do të thotë *fron*. Arshi nuk është ndonjë krijesë, por është një term për të treguar pozitën e Zotit që është përtej të përtejmes. Arshi nuk është ndonjë karrige a fron fizik, ku Zoti të jetë i ulur siç ulet njeriu. Ajeti dhe shumë ajete si ky tregojnë se Zoti, pasi përcaktoi lidhjen e Krijuesit me të gjitha krijesat, pra, pasi i krijoi ato, u vendos në Arsh, që do të thotë se pas të gjitha krijimeve, Ai sërish është i Veçuar. Kështu që, koncepte që Zoti qëndron me njeriun (4:109; 58:8 etj.), Ai përfshin çdo gjë, etj., janë attribute të Tij në të cilat Ai e ka mundësuar edhe njeriun të marrë pjesë, në mënyrë që edhe njeriu ta perceptojë afrimin me Të. Dhe për të treguar se Ai është përtej çdo krijese, Ai është i Shenjti dhe i Pastri nga çdo e metë, tha se pas krijimit Ai është vendosur në Arsh, në mënyrë që të provohet se Ai është Një, i Vetëm, i Pashoq dhe i pastër nga çdo atribut njerëzor. Pra, Arshi me fjalë të tjera janë atributet e Tij ekskluzive. Një kuptim tjetër i vendosjes së Zotit në Arsh është se Zoti, pasi krijoi qiejt dhe tokën, manifestoi atributet e Tij. Atributet e Tij janë të përhershme, por atributi Krijues kërkon krijesë që të njihet, atributi Furnizues kërkon nevojtar, e me radhë. Manifestimi i këtyre atributiveve gjithashtu quhet vendosja në Arsh. Si një mbret që sundon dhe ruan popullin e tij duke u ulur në fronin e tij. Kështu, fjalët “*më pas Ai u vendos mbi Arsh*” tregojnë manifestimin e Zotit që Ai bëri pasi “*krijoi qiejt dhe tokën*”. Pra, Atij i takon edhe krijimi, edhe sundimi. Lexoni edhe 42:12; 11:8; 57:5; 69:18.

16. Fjala *muhsin* (mirëbërës) do të thotë ai që përpiket maksimalisht për të bërë vepra të mira

58. Është Ai që dërgon erërat si lajmëmira përpara mëshirës së Tij. Kur ato mbartin re të ngarkuara, Ne i shpiem drejt një toke të vdekur, lëshojmë ujë prej tyre dhe nxjerrim përmes tij (pra, përmes ujit) gjithfarë frutash. Kështu i nxjerrim të vdekurit (duke i ringjallur), që ju të reflektoni.<sup>17</sup>

59. Toka e mirë nxjerr bimësinë e saj me lejen e Zotit të vet, kurse ajo që është e papastër, nuk nxjerr asgjë, përveç gjërave të pavlera. Ne kështu i përsërisim shenjat për njerëzit që falënderojnë.

60. Sigurisht, kemi dërguar Nuhun te populli i tij. Ai tha: “O populli im! Adhuroni Allahun; nuk keni ndonjë të adhurueshëm tjetër përveç Atij. Njëmend, unë druaj për ndëshkimin e një dite të rëndë mbi ju.”

61. Prijësit e popullit të tij thanë: “(Kurse) ne me gjithëmend ty të shohim në humbje të qartë!”

62. Ai tha: “O populli im! Nuk jam unë në humbje, përkundrazi, jam i dërguar nga Zoti i botëve.

وَهُوَ الَّذِي يُرْسِلُ الرِّيحَ بُشْرًا بَيْنَ يَدَيْ رَحْمَتِهِ ۗ حَتَّىٰ إِذَا أَقَلَّتْ سَحَابًا ثِقَالًا سُقْنَاهُ لِبَلَدٍ مَّيِّتٍ فَأَنْزَلْنَا بِهِ الْمَاءَ فَأَخْرَجْنَا بِهِ مِنْ كُلِّ الثَّمَرَاتِ ۗ كَذَٰلِكَ نُخْرِجُ الْمَوْتَىٰ لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ ﴿٥٨﴾

وَالْبَلَدُ الظَّمِيبُ يَخْرُجُ نَبَاتُهُ بِإِذْنِ رَبِّهِ ۗ وَالَّذِي خَبثَ لَا يَخْرُجُ إِلَّا نَكْدًا ۗ كَذَٰلِكَ نُصَرِّفُ الْآيَاتِ لِقَوْمٍ لَّا يَشْكُرُونَ ﴿٥٩﴾

لَقَدْ أَرْسَلْنَا نُوحًا إِلَىٰ قَوْمِهِ فَقَالَ يَقَوْمِ اعْبُدُوا اللَّهَ مَا لَكُمْ مِنْ إِلَهٍ غَيْرُهُ ۗ إِنِّي أَخَافُ عَلَيْكُمْ عَذَابَ يَوْمٍ عَظِيمٍ ﴿٦٠﴾

قَالَ الْمَلَأُ مِنْ قَوْمِهِ إِنَّا لَنَرَاكَ فِي ضَلَالٍ مُّبِينٍ ﴿٦١﴾

قَالَ يَقَوْمِ لَيْسَ بِي ضَالَّةٌ ۗ وَلَكِنِّي رَسُولٌ مِّنْ رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿٦٢﴾

në mënyrë të përsosur. Në një hadith të famshëm Profeti Muhammed<sup>saws</sup> tha se *muhsin* është ai që bën të mira në atë mënyrë sikur e sheh Zotin, ose të paktën është i vetëdijshëm se Zoti po e sheh atë (Buhari, nr. 50).

17. Shembulli i dhënë, siç thotë ajeti, është “që ju të reflektoni”. Pra, Zoti thotë – ashtu siç Unë e ringjall tokën pas vdekjes së saj me ujin qiellor, në të njëjtën mënyrë, kur njerëzimi degradohet dhe devijon tërësisht nga rruga e drejtë, në tokën e zemrës së njeriut Unë lëshoj ujin qiellor, zbulesën, nëpërmjet së cilës shpirtat e vdekur ringjallen.

63. Ju përcjell mesazhet e Zotit tim, ju këshilloj dhe di prej Allahut atë që ju nuk e dini.

أَبْلَغُكُمْ رَسُولَ رَبِّي وَأَنْصَحَ لَكُمْ  
وَأَعْلَمَ مِنَ اللَّهِ مَا لَا تَعْلَمُونَ ﴿١٧﴾

64. A u çuditët se përse ju ka ardhur një këshillë prej Zotit tuaj, që (u zbrit) mbi një burrë nga gjiri juaj, që t'ju alarmojë, që ju të keni drujtje dhe që ndoshta të mëshiroheni?!"

أَوْ عَجِبْتُمْ أَنْ جَاءَكُمْ ذِكْرٌ مِنْ رَبِّكُمْ  
عَلَى رَجُلٍ مِنْكُمْ لِيُنذِرَكُمْ وَتُنقُوا  
وَلَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ ﴿١٨﴾

65. Ata e quajtën gënjeshtar. Andaj, Ne e shpëtuam atë, si dhe ata që ishin me të në arkë, kurse ata që i quajtën gënjeshtria ajetet Tona, i fundosëm. Sigurisht, ata ishin një popull i verbër.

فَكَذَّبُوهُ فَأَنْجَيْنَاهُ وَالَّذِينَ مَعَهُ فِي  
الْفُلِّ وَأَعْرَفْنَا الَّذِينَ كَذَّبُوا بِآيَاتِنَا  
إِنَّهُمْ كَانُوا قَوْمًا عَمِينَ ﴿١٩﴾

66. Dhe tek adët (dërguam) vëllain e tyre, Hudin. Ai tha: "O populli im! Adhuroni Allahun, nuk keni të adhurueshëm tjetër përveç Atij. A nuk druheni?!"<sup>18</sup>

وَالِى عَادٍ أَخَاهُمْ هُودًا قَالَ يُقَوْمِ  
اعْبُدُوا اللَّهَ مَا لَكُمْ مِنْ إِلَهٍ غَيْرُهُ  
أَفَلَا تَتَّقُونَ ﴿٢٠﴾

67. Prijësit që mohuan nga populli i tij, thanë: "Pa dyshim, ne ty të shohim të pamend dhe mendojmë se je nga gënjeshtarët."

قَالَ الْمَلَأُ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ قَوْمِهِ إِنَّا  
نَنزِلُكَ فِي سَفَاهَةٍ وَإِنَّا نَنظُنُّكَ مِنَ  
الْكَاذِبِينَ ﴿٢١﴾

68. Ai tha: "O populli im! Unë nuk jam i pamend, përkundrazi, jam i dërguar nga Zoti i botëve.

قَالَ يُقَوْمِ لَيْسَ بِي سَفَاهَةٌ وَلَكِنِّي رَسُولٌ  
مِنْ رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿٢٢﴾

69. Ju përcjell mesazhet e Zotit tim dhe jam për ju një këshilltar i besueshëm.

أَبْلَغُكُمْ رَسُولَ رَبِّي وَأَنَا لَكُمْ ناصِحٌ  
آمِينٌ ﴿٢٣﴾

18. Adët ishin një popull i lashtë në Arabi. Dikur ata sunduan pjesën më të madhe të zonës pjellore të Arabisë së Madhe, konkretisht Jemenin, Sirinë dhe Mesopotaminë. Historikisht, ata ishin populli i parë që ushtruan dominimin e tyre në mbarë Arabinë. Ata quhen adët e parë (arab. 'adul-ula).

70. A u çuditët se përse ju ka ardhur një këshillë prej Zotit tuaj, që (u zbrit) mbi një burrë nga gjiri juaj, që t'ju alarmojë?! Dhe kujtojeni kur Ai ju bëri mëkëmbës pas popullit të Nuhut dhe jua shtoi shumë lindshmërinë. Ndaj, kujtojini bekimet e Allahut, që të keni sukses.”

أَوْ عَجِبْتُمْ أَنْ جَاءَكُمْ ذِكْرٌ مِّن رَّبِّكُمْ  
عَلَى رَجُلٍ مِّنكُمْ لِيُنذِرَكُمْ ۖ وَذُكِّرُوا  
إِذْ جَعَلَكُمْ خُلَفَاءَ مِنْ بَعْدِ قَوْمِ نُوحٍ  
وَ زَادَكُمْ فِي الْخَلْقِ بَضْطَةً ۗ فَادْكُرُوا  
آلَاءَ اللَّهِ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ ﴿٧٠﴾

71. Ata thanë: “A erdhe që ne ta adhurojmë Allahun e Vetëm e t'i lëmë ata që baballarët tanë i adhuronin?! Na sill pra atë, nga e cila na alarmon, po qe se je ndër të vërtetët!”

قَالُوا أَجِئْنَا لِنُعْبَدَ اللَّهَ وَحْدَهُ وَنَذَرَ مَا  
كَانَ يَعْبُدُ آبَاؤُنَا ۖ فَاتَّبِعْنَا إِن كُنتَ  
مِنَ الصَّادِقِينَ ﴿٧١﴾

72. Ai tha: “Tashmë ranë mbi ju nga Zoti juaj ndyrësi dhe ndëshkim. A po grindeni me mua për ca emra që i keni emërtuar ju dhe baballarët tuaj, për të cilët Allahu nuk zbriti asnjë argument?! Prisi pra, edhe unë po pres me ju.”

قَالَ قَدْ وَقَعَ عَلَيْكُمْ مِّن رَّبِّكُمْ رِجْسٌ  
وَغَضَبٌ ۖ أَتُجَادِلُونَنِي فِي أَسْمَاءٍ  
سَمَّيْتُمُوهَا أَنْتُمْ وَآبَاؤُكُمْ مَا نَزَّلَ اللَّهُ  
بِهَا مِنْ سُلْطٰنٍ ۖ فَانظُرُوا إِلَيَّ مَعَكُمْ  
مِّنَ الْمُنظَرِينَ ﴿٧٢﴾

73. Prandaj, Ne, përmes mëshirës Sonë e shpëtuam atë, si dhe ata që ishin me të dhe ua këputëm rrënjën atyre që i quajtën gënjeshtër ajetet Tona. Ata nuk do të bëheshin besimtarë.

فَأَنْجَيْنَاهُ وَالَّذِينَ مَعَهُ بِرَحْمَةٍ مِنَّا  
وَقَطَعْنَا دَابِرَ الَّذِينَ كَذَّبُوا بِآيَاتِنَا وَمَا كَانُوا  
مُؤْمِنِينَ ﴿٧٣﴾

74. Dhe te themudët<sup>19</sup> (dërguam) vëllain e tyre, Salihun.<sup>20</sup> Ai tha: “O populli im! Adhuroni Allahun, nuk keni të adhureshëm tjetër përveç

وَإِلَى ثَمُودَ أَخَاهُمْ صٰلِحًا ۖ قَالَ يَا قَوْمِ  
اعْبُدُوا اللَّهَ مَا لَكُمْ مِّنْ إِلٰهٍ غَيْرُهُ ۖ قَدْ  
جَاءَكُمْ بَيِّنَةٌ مِّن رَّبِّكُمْ ۖ هَذِهِ نٰقَةٌ

19. Themudët jetuan në pjesën perëndimore të Arabisë, në zonat që shtriheshin nga Edeni deri në veri në kufi me Sirinë. Ata jetuan para kohës së Ismailit<sup>as</sup>. Territori i tyre kufizohej me atë të adëve, por ata në përgjithësi jetonin nëpër kodra.

20. Salihu<sup>as</sup> jetoi pas Hudit<sup>as</sup>, dhe mund të ketë qenë bashkëkohës i Hazret Ibrahimit<sup>as</sup>.

Atij. Tashmë ju ka ardhur një provë e qartë nga Zoti juaj. Kjo është deveja e Allahut, një shenjë për ju, andaj, lëreni atë të ushqehet në tokën e Allahut dhe mos e prekni me të keqe, sepse do t'ju zërë një ndëshkim i dhimbshëm.<sup>21</sup>

اللَّهُ لَكُمْ آيَةٌ فَذُرُّهَا تَأْكُلُ فِي أَرْضِ  
اللَّهِ وَلَا تَمْسُوهَا بِسُوءٍ فَيَأْخُذَكُمْ عَذَابُ  
الْيَمِيمِ ﴿٧٥﴾

75. Dhe kujtojeni kur Ai ju bëri mëkëmbës pas adëve dhe ju populloi në tokë. Ju ndërtonit kështjella nëpër fushat e saj dhe gdhendnit malet për të bërë shtëpi. Andaj, kujtojini bekimet e Allahut dhe mos bëni trazira në tokë si çrregullues.”

وَاذْكُرُوا إِذْ جَعَلَكُمْ خُلَفَاءَ مِنْ بَعْدِ  
عَادٍ وَبَوَّأَكُمْ فِي الْأَرْضِ تَتَّخِذُونَ مِنْ  
سُهُولِهَا قُصُورًا وَتَنْحِتُونَ الْجِبَالَ  
بُيُوتًا ۖ فَادْكُرُوا الْآءَ اللَّهِ وَلَا تَعْتُوا  
فِي الْأَرْضِ مُفْسِدِينَ ﴿٧٥﴾

76. Prijësit e popullit të tij që ishin mendjemëdhenj, u thanë atyre që mendonin se ishin të dobët, pra besimtarëve: “A keni dijeninë që Salihu është i dërguar nga Zoti i tij?” Ata u thanë: “Ne pa dyshim që e besojmë atë (mesazh), me të cilin ai ka ardhur.”

قَالَ الْمَلَأُ الَّذِينَ اسْتَكْبَرُوا مِنْ قَوْمِهِ  
لِلَّذِينَ اسْتَضَعِفُوا لِمَنْ آمَنَ مِنْهُمْ  
اتَّعْلَمُونَ أَنَّ صَالِحًا مُّرْسَلٌ مِنْ رَبِّهِ ۗ  
قَالُوا إِنَّا بِمَا أُرْسِلَ بِهِ مُؤْمِنُونَ ﴿٧٦﴾

77. Mendjemëdhenjtë thanë: “Ne pa dyshim që e mohojmë atë që besuat ju.”

قَالَ الَّذِينَ اسْتَكْبَرُوا إِنَّا بِالَّذِي آمَتُمْ بِهِ  
كٰفِرُونَ ﴿٧٧﴾

78. Ata ia prenë këmbët devesë (për ta therur), e kundërshtuan urdhrin e Zotit të tyre dhe thanë: “O Salih! Sille atë nga e cila na alarmon, po qe se je ndër të Dërguarit.”

فَعَقَرُوا النَّاقَةَ وَعَتَوْا عَنْ أَمْرِ رَبِّهِمْ  
وَقَالُوا لِيُصَلِّحْ لَنَا بِمَا نَعَدْنَا إِنْ كُنْتَ مِنَ  
الْمُرْسَلِينَ ﴿٧٨﴾

21. Deveja ishte mjeti kryesor i transportit në atë zonë dhe pikërisht me devenë e tij Profeti Salih<sup>as</sup> udhëtonte nga një vend në tjetrin për të predikuar mesazhin e Zotit. Vënia e pengesave në lëvizjen e lirë të devesë apo dëmtimi i saj ishte i barabartë me pengimin e punës që Zoti i kishte besuar Salihut<sup>as</sup>, përndryshe, deveja e tij nuk qe ndonjë kafshë e pazakontë.

79. Ata i zuri një tërmet i rëndë, dhe mbetën përmbys në shtëpitë e tyre.

فَأَخَذَتْهُمُ الرَّجْفَةُ فَأَصْبَحُوا فِي دَارِهِمْ  
جُثْمِينَ ﴿٧٩﴾

80. (Salihu) u kthye nga ata dhe tha: “O populli im! Unë jua dhashë mesazhin e Zotit tim dhe ju këshillova, por ju nuk i doni këshilltarët.”

فَتَوَلَّى عَنْهُمْ وَقَالَ يَاقَوْمِ لَقَدْ أَبْلَغْتُكُمْ  
رِسَالَةَ رَبِّي وَنَصَحْتُ لَكُمْ وَلَكِنْ لَا  
تُحِبُّونَ النَّصِيحِينَ ﴿٨٠﴾

81. Dhe (e dërguam edhe) Lutin, kur ai i tha popullit të tij: “A bëni paturpësinë që nuk e ka bërë askush më parë në botë?!<sup>22</sup>”

وَلَوْطًا إِذْ قَالَ لِقَوْمِهِ أَتَأْتُونَ الْفَاحِشَةَ مَا  
سَبَقَكُمْ بِهَا مِنْ أَحَدٍ مِنَ الْعَالَمِينَ ﴿٨١﴾

82. Ju shkoni me burrat për epshe, në vend të grave. Madje, jeni një popull i shthurur.”

إِنَّكُمْ لَتَأْتُونَ الرِّجَالَ شَهْوَةً مِنْ دُونِ  
النِّسَاءِ ۗ بَلْ أَنْتُمْ قَوْمٌ مُّسْرِفُونَ ﴿٨٢﴾

83. Populli i tij nuk kishte përgjigje, veçse të thoshin: “Dëbojini këta nga fshati juaj; po bëhen njerëz të pastër!”

وَمَا كَانَ جَوَابَ قَوْمِهِ إِلَّا أَنْ قَالُوا  
أَخْرِجُوهُمْ مِنْ قَرْيَتِكُمْ ۗ إِنَّهُمْ أَنَاسٌ  
يَتَّبِعُونَ ﴿٨٣﴾

84. Andaj, Ne e shpëtuam atë dhe familjen e tij, përveç gruas së tij. Ajo ishte me ata që mbetën mbrapa.

فَأَنْجَيْنَاهُ وَأَهْلَهُ إِلَّا امْرَأَتَهُ ۗ كَانَتْ مِنَ  
الْغَابِرِينَ ﴿٨٤﴾

85. Dhe lëshuam mbi ta një shi. Shiko se si ishte fundi i fajtorëve!

وَآمَطْنَا عَلَيْهِمْ مَطْرًا ۗ فَاَنْظُرْ كَيْفَ كَانَ  
عَاقِبَةُ الْمُجْرِمِينَ ﴿٨٥﴾

86. Dhe te Medjeni (dërguam) vëllain e tyre, Shuajbin. Ai tha: “O populli im! Adhuroni Allahun, nuk keni të adhurueshëm tjetër përveç Atij. Juve ju ka ardhur provë e qartë nga Zoti juaj. Andaj, përmbushni masën dhe peshën, mos u pakësoni

وَالِى مَدْيَنَ أَخَاهُمْ شُعَيْبًا ۗ قَالَ يَاقَوْمِ  
اعْبُدُوا اللَّهَ مَا لَكُمْ مِنْ إِلَهٍ غَيْرُهُ ۗ قَدْ  
جَاءَتْكُمْ بَيِّنَةٌ مِنْ رَبِّكُمْ فَأَوْفُوا  
الْكَيْلَ وَالْمِيزَانَ وَلَا تَبْخَسُوا النَّاسَ

22. Luti (Loti)<sup>as</sup> ishte nipi dhe bashkëkohësi i Hazret Ibrahimit<sup>as</sup> (Bibla, Zanafilla 11:27, 31).

njerëzve gjërat e tyre dhe mos bëni çrregullim në tokë pas përmirësimit të saj. Kjo është më mirë për ju, nëse jeni besimtarë.<sup>23</sup>

87. Mos u ulni në çdo rrugë, duke e kërcënuar dhe duke e penguar nga rruga e Allahut atë që besoi në Të, duke dashur shtrembësi në këtë (rrugë). Kujtojeni kur ju ishit të paktë dhe Ai ju shtoi. Dhe shihni se si ishte fundi i çrregulluesve.

88. Nëse një grup prej jush e besoi atë, me të cilën kam ardhur dhe një grup tjetër nuk e besoi, duroni derisa Allahu të gjykojë mes nesh. Ai është Gjykatësi më i mirë.”

Xhuzi 9

89. Prijësit e popullit të tij që ishin mendjemëdhenj, thanë: “O Shuajb, ne përnjëmend do të të dëbojmë nga fshati ynë ty dhe ata që besuan me ty, ose ju duhet të ktheheni në grupin tonë.” Ai tha: “Vallë, edhe kur ne e urrejmë (këtë)?!

90. Po u kthyem në grupin tuaj pasi na ka shpëtuar Allahu prej tij, pa dyshim do të trillonim gënjeshtër mbi Allahun. Nuk është e mundur

أَشْيَاءَهُمْ وَلَا تُفْسِدُوا فِي الْأَرْضِ بَعْدَ  
إِصْلَاحِهَا ذَلِكُمْ خَيْرٌ لَّكُمْ إِن كُنتُمْ  
مُؤْمِنِينَ ﴿٢٧﴾

وَلَا تَقْعُدُوا بِكُلِّ صِرَاطٍ تُوعِدُونَ  
وَتَصُدُّونَ عَنْ سَبِيلِ اللَّهِ مَنْ آمَنَ بِهِ  
وَتَبْغُونَهَا عِوَجًا ۗ وَادْكُرُوا إِذْ كُنتُمْ قَلِيلًا  
فَكَثَرْتُمْ ۗ وَانظُرُوا كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ  
الْمُفْسِدِينَ ﴿٢٨﴾

وَإِنْ كَانَ طَآئِفَةٌ مِّنْكُمْ أَمَنُوا بِآلِدِيَّ  
أَرْسَلْتُ بِهِ وَطَآئِفَةٌ لَّمْ يُؤْمِنُوا فَاصْبِرُوا  
حَتَّىٰ يَحْكُمَ اللَّهُ بَيْنَنَا ۗ وَهُوَ خَيْرُ  
الْحَاكِمِينَ ﴿٢٩﴾

﴿٣٠﴾ قَالَ الْمَلَأُ الَّذِينَ اسْتَكْبَرُوا مِنْ قَوْمِهِ  
لنُخْرِجَنَّكَ لِيُشَعِّبَ وَالَّذِينَ آمَنُوا مَعَكَ  
مِنْ قَرِينِنَا أَوْ لَنَعُودَنَّ فِي مِلَّتِنَا قَالَ  
أَوَلَوْ كُنَّا كَرِهِينَ ﴿٣١﴾

قَدْ افْتَرَيْنَا عَلَى اللَّهِ كَذِبًا إِنْ عُدْنَا فِي  
مِلَّتِكُمْ بَعْدَ إِذْ نَجَّيْنَا اللَّهُ مِنْهَا ۗ وَمَا  
يَكُونُ لَنَا أَنْ نَعُودَ فِيهَا إِلَّا أَنْ يَشَاءَ اللَّهُ

23. Midiani ishte djali i Abrahamit (Ibrahimit<sup>as</sup>) nga gruaja e tij Keturah (Bibla, Zanafilla. 25:1-2). Pasardhësit e tij u vendosën në veri të Hixhazit. Midian ishte gjithashtu emri i një qyteti në Detin e Kuq, përballë Sinait afër bregut arab. Qyteti u quajt kështu sepse ishte i banuar nga pasardhësit e Midianit. Disa e kanë quajtur atë si një port detar për shkak të afërsisë së tij me detin, duke qenë i vendosur vetëm në një distancë prej rreth tetë miljesh nga Gjiri i Akabasë. Midiani kishte një popullsi të madhe të pasardhësve të Ismailit<sup>as</sup>.

për ne që të kthehemi në të, përveçse nëse dëshiron Allahu, Zoti ynë. Zoti ynë përfshin çdo gjë me dije. Allahut i mbështetemi ne. O Zoti ynë! Vendos me drejtësi midis nesh e popullit tonë dhe Ti je më i miri për të vendosur.”

91. Prijësit e popullit të tij që mohuan, u thanë: “Po e ndoqët Shuajbin, do të jeni humbës.”

92. Atëherë, ata i zuri tërmeti dhe ata mbetën përmbys nëpër shtëpitë e tyre.

93. Ata që e quajtën gënjeshtar Shuajbin, u bënë sikur nuk kishin jetuar në atë (vend). Ata që e quajtën gënjeshtar Shuajbin, dolën humbës.

94. Ai u shmang nga ata dhe tha: “O populli im! Jua kam kumtuar mesazhet e Zotit tim dhe ju kam këshilluar. E si mund të pikëllohem për një popull mohues?!”

95. Në çdo qytet ku dërguam ndonjë profet, i kapëm banorët e tij me anë të skamjes dhe vështirësisë, që ata të përgjërohen.

96. Më pas e ndërruam të keqen me të mirën, derisa ata shmangën (këtë) dhe thanë: “(Edhe) etërit tanë i preku skamja dhe kamja”, atëherë i zumë befaz, kur ata nuk ishin të ndërgjegjshëm.

رَبَّنَا وَسِعَ رَبُّنَا كُلَّ شَيْءٍ عِلْمًا عَلَى  
اللَّهِ تَوَكَّلْنَا رَبَّنَا افْتَحْ بَيْنَنَا وَبَيْنَ قَوْمِنَا  
بِالْحَقِّ وَأَنْتَ خَيْرُ الْفَاتِحِينَ ﴿١٠﴾

وَقَالَ الْمَلَأَ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ قَوْمِهِ لِيَنَّ  
الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ قَوْمِنَا أَكْبَرُ مِنْكُمْ إِذْ أَخْسَرُوا ﴿١١﴾

فَأَخَذْتَهُمُ الرَّجْفَةُ فَأَصْبَحُوا فِي دَارِهِمْ  
جُثْمِينَ ﴿١٢﴾

الَّذِينَ كَذَّبُوا شُعَيْبًا كَانُوا يَمُوتُونَ فِيهَا  
الَّذِينَ كَذَّبُوا شُعَيْبًا كَانُوا هُمُ  
الْخَاسِرِينَ ﴿١٣﴾

فَتَوَلَّى عَنْهُمْ وَقَالَ يَوْمَ لَقَدْ أَبْلَغْتُكُمْ  
رِسَالَاتِ رَبِّي وَنَصَحْتُ لَكُمْ فَكَيْفَ آسَأُ  
عَلَى قَوْمٍ كُفِرِينَ ﴿١٤﴾

وَمَا أَرْسَلْنَا فِي قَرْيَةٍ مِّن نَّبِيٍّ إِلَّا أَخَذْنَا  
أَهْلَهَا بِالْبَأْسَاءِ وَالضَّرَّاءِ لَعَلَّهُمْ  
يَضُرَّعُونَ ﴿١٥﴾

ثُمَّ بَدَّلْنَا مَكَانَ السَّيِّئَةِ الْحَسَنَةَ حَتَّى  
عَفَوْا وَوَقَالُوا قَدْ مَسَّ آبَاءَنَا الضَّرَّاءُ  
وَالسَّرَّاءُ فَأَخَذْنَاهُمْ بَغْتَةً وَهُمْ لَا  
يَشْعُرُونَ ﴿١٦﴾



97. Sikur banorët e qyteteve të besonin e të druheshin (ndaj Nesh), patjetër do t'u çelnim bekime prej qiellit dhe tokës, por ata mohuan, andaj, i kapëm për shkak të asaj që bënin.

98. A janë të sigurt banorët e qyteteve që atyre nuk do t'u vijë ndëshkimi Ynë gjatë natës kur ata flenë?!

99. Ose, a janë të sigurt banorët e qyteteve që nuk do t'u vijë ndëshkimi Ynë gjatë ditës kur ata dëfrehen?!

100. Pra, a janë të sigurt ata nga strategjia e Allahut? Përveç popullit humbës, askush nuk rri i sigurt përballë strategjisë së Allahut.

101. A nuk morën mësim ata që trashëguan tokën pas banorëve të saj (të mëparshëm), të cilët për mëkatet e tyre, po të duam Ne, do t'i ndëshkojmë dhe do t'ua vulosim zemrat, më pas, ata nuk do të marrin vesh asgjë?!

102. Këto janë qytetet, lajmet e të cilave Ne t'i rrëfejme ty. Sigurisht, të Dërguarit e tyre u erdhën me shenjat e qarta, por ata nuk arritën t'i besonin, për shkak se (i) quajtën gënjeshtarë (Profetët e tjerë edhe) më parë. Kështu Allahu ua vulos zemrat mohuesve.

103. Shumicën e tyre nuk i gjetëm të besës. Shumicën e tyre i gjetëm të ligj.

وَلَوْ أَنَّ أَهْلَ الْقُرَىٰ آمَنُوا وَاتَّقَوْا لَفَتَحْنَا  
عَلَيْهِمْ بَرَكَاتٍ مِّنَ السَّمَاءِ وَ الْأَرْضِ  
وَلَكِن كَذَّبُوا فَأَحَذْنَهُمْ بِمَا كَانُوا  
يَكْسِبُونَ ﴿٧٧﴾

أَفَأَمِنَ أَهْلَ الْقُرَىٰ أَنْ يَأْتِيَهُمْ بَأْسُنَا  
بَيَاتًا وَهُمْ نَائِمُونَ ﴿٧٨﴾

أَوْ آمِنَ أَهْلَ الْقُرَىٰ أَنْ يَأْتِيَهُمْ بَأْسُنَا  
ضُحًى وَهُمْ يَلْعَبُونَ ﴿٧٩﴾

أَفَأَمِنُوا مَكْرَ اللَّهِ ۚ فَلَا يَأْمَنُ مَكْرَ اللَّهِ  
إِلَّا الْقَوْمُ الْخَاسِرُونَ ﴿٨٠﴾

أَوَلَمْ يَهْدِ لِلَّذِينَ يَرْتُونَ الْأَرْضَ مِنْ  
بَعْدِ أَهْلِهَا أَنْ لَوْ نَشَاءُ لَصَبَلْنَاهُمْ  
بِذُنُوبِهِمْ ۚ وَنَطْبَعُ عَلَىٰ قُلُوبِهِمْ فَهُمْ لَا  
يَسْمَعُونَ ﴿٨١﴾

تِلْكَ الْقُرَىٰ نَقُصُّ عَلَيْكَ مِنْ أَنْبَاءِهَا  
وَلَقَدْ جَاءَتْهُمْ رُسُلُهُمْ بِالْبَيِّنَاتِ  
فَمَا كَانُوا لِيُؤْمِنُوا بِمَا كَذَّبُوا مِنْ قَبْلُ  
كَذَلِكَ يَطْبَعُ اللَّهُ عَلَىٰ قُلُوبِ الْكٰفِرِينَ ﴿٨٢﴾

وَمَا وَجَدْنَا لِأَكْثَرِهِمْ مِنْ عَهْدٍ ۚ وَإِنْ  
وَجَدْنَا أَكْثَرَهُمْ لَفٰسِقِينَ ﴿٨٣﴾

104. Pas tyre dërguam Musain me shenjat Tona drejt Faraonit dhe prijësve të tij. Ata u bënë padrejtësi atyre (shenjave). Shih pra, se si ishte fundi i çrregulluesve.

ثُمَّ بَعَدْنَا مِنْ بَعْدِهِمْ مُوسَىٰ بِآيَاتِنَا إِلَىٰ فِرْعَوْنَ وَمَلَئِهِ فَظَلَمُوا بِهَا ۖ فَانظُرْ كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ الْمُفْسِدِينَ ﴿١٠٤﴾

105. Musai tha: “O Faraon! Unë sigurisht jam i Dërguar nga Zoti i botëve.

وَقَالَ مُوسَىٰ يُعْرَعُونَ إِيَّيْ رَسُولَ مِنْ رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿١٠٥﴾

106. Kam për detyrë të mos flas për Allahun asgjë tjetër përveç së vërtetës. Ju kam ardhur me një shenjë të qartë nga Zoti juaj, andaj, nisi me mua bijtë e Izraelit.”

حَقِيقٌ عَلَىٰ أَنْ لَا أَقُولَ عَلَىٰ اللَّهِ إِلَّا الْحَقُّ ۗ قَدْ جِئْتُكُمْ بِبَيِّنَةٍ مِنْ رَبِّكُمْ فَأَرْسِلْ مَعِيَ بَنِي إِسْرَائِيلَ ﴿١٠٦﴾

107. Ai tha: “Nëse ke ardhur me ndonjë shenjë, paraqite, po qe se je i vërtetë.”

قَالَ إِنْ كُنْتَ جِئْتَ بِآيَةٍ فَأْتِ بِهَا إِنْ كُنْتَ مِنَ الصَّادِقِينَ ﴿١٠٧﴾

108. Atëherë ai hodhi shkopin e tij, që u bë papritmas gjarpër i madh, i dukshëm.

فَأَلْقَىٰ عَصَاهُ فَإِذَا هِيَ ثُعْبَانٌ مُّبِينٌ ﴿١٠٨﴾

109. Dhe nxori dorën e tij, që sakaq ishte e bardhë për shikuesit.<sup>24</sup>

فَنَزَعَ يَدَهُ فَإِذَا هِيَ بَيْضَاءُ لِلنَّاظِرِينَ ﴿١٠٩﴾

110. Prijësit e popullit të Faraonit thanë: “Ky përnjëmend qenka mjeshtër magjistar.

قَالَ الْمَلَأُ مِنْ قَوْمِ فِرْعَوْنَ إِنَّ هَذَا لَسَاحِرٌ عَلِيمٌ ﴿١١٠﴾

111. Ai do që t’ju dëbojë nga toka juaj.” Atëherë (Faraoni tha): “Çfarë po (më) këshilloni ju?”

يُرِيدُ أَنْ يُخْرِجَكُمْ مِنْ أَرْضِكُمْ ۖ فَمَاذَا تَأْمُرُونَ ﴿١١١﴾

112. Ata thanë: “Lëshoji një afat këtij dhe vëllait të tij dhe dërgo tubuesit nëpër qytete,

قَالُوا أَرْجِهْ وَأَخَاهُ وَأَرْسِلْ فِي الْمَدَائِنِ حَاشِرِينَ ﴿١١٢﴾

24. Lexoni 27:13.

113. që të të sjellin çdo mjeshtër magjistar.”

يَأْتُوكَ بِكُلِّ سِحْرِ عَلَيْهِ ۝١١٣

114. Dhe erdhën magjistarët te Faraoni. Thanë: “Me siguri do të kemi shpërblim, në qoftë se ne dalim mundës.”

وَجَاءَ السَّحَرَةُ فِرْعَوْنَ قَالُوا إِنَّ لَنَا لَأَجْرًا  
إِنْ كُنَّا نَحْنُ الْغَالِبِينَ ۝١١٤

115. Ai tha: “Po, madje do të bëheni edhe ndër të afërmit.”

قَالَ نَعَمْ وَإِنَّكُمْ لِمِنَ الْمُتَقَرَّبِينَ ۝١١٥

116. Ata thanë: “O Musa! Ose hidh ti, ose të hedhim ne.”

قَالُوا يَمُوسَى إِمَّا أَنْ تُلْقَى وَإِمَّا أَنْ  
تَكُونَ نَحْنُ الْمُلْقِينَ ۝١١٦

117. (Musai) tha: “Hidhni!” E kur ata hodhën, i magjepsën sytë e njerëzve, i trembën dhe bënë një magji të madhe.

قَالَ أَلْقُوا فَلَمَّا أَلْقَوْا سَحَرُوا أَعْيُنَ  
النَّاسِ وَاسْتَهْبَاهُوهُمْ وَجَاءُوا بِسِحْرِ  
عَظِيمٍ ۝١١٧

118. Dhe Ne i shpallëm Musait: “Hidhe shkopin tënd!” Dhe ai (shkop) menjëherë filloi t'i gëlltiste gjithçka që ata kishin sajuar.<sup>25</sup>

وَأَوْحَيْنَا إِلَىٰ مُوسَىٰ أَنْ أَلِقِ عَصَاكَ  
فَإِذَا هِيَ تَلْقَفُ مَا يَأْفِكُونَ ۝١١٨

119. Pra, u vendos e vërteta dhe ajo që ata bënë, doli e rreme.

فَوَقَعَ الْحَقُّ وَبَطَلَ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ۝١١٩

120. Këtu ata u mundën dhe dolën të poshtëruar.

فَغَلَبُوا هُنَالِكَ وَانْقَلَبُوا صُغْرَيْنَ ۝١٢٠

121. Dhe magjistarët ranë në sexhde.

وَأَلْقَى السَّحَرَةُ سُجُودِينَ ۝١٢١

122. Thanë: “Besuam në Zotin e botëve,

قَالُوا آمَنَّا بِرَبِّ الْعَالَمِينَ ۝١٢٢

25. Në ajetet 117-118 përmendet realiteti i magjisë (*sühr*). Zoti i Madhërishëm pohon: “ata i magjepsën sytë e njerëzve”. Kjo tregon se litarët e magjistarëve nuk patën asnjë ndryshim, por magjistarët u bënë një lloj hipnotizmi syve të shikuesve, që ato iu dukën në një formë tjetër. Edhe Hazret Musai<sup>as</sup> u ndikua nga kjo, por kur Allahu i Madhërishëm i tha të hidhte shkopin, u thye magjia e magjistarëve, edhe shikuesit u kthjelluan, duke kuptuar realitetin.

123. Zotin e Musait dhe të Harunit.”

رَبِّ مُوسَىٰ وَهَارُونَ ﴿٣٧﴾

124. Faraoni tha: “A e besuat përpara se unë t’ju lejoj?! Kjo pa dyshim është një intrigë që e keni intriguar në qytet, që t’i nxirrni banorët prej tij. Do të mësoni së shpejti.

قَالَ فِرْعَوْنُ اٰمْتُمْ بِهٖ قَبْلَ اَنْ اٰذَنَ لَكُمْ ؕ  
اِنَّ هٰذَا لَمَكْرٌ مَّكْرْتُمُوْهُ فِى الْمَدِيْنَةِ  
لِيَخْرِجُوْا مِنْهَا اَهْلَهَا ؕ فَسَوْفَ تَعْلَمُوْنَ ﴿٣٧﴾

125. Unë përnjëmend do t’ju pres duart dhe këmbët të anëve të ndryshme, më pas do t’ju kryqëzoj të gjithë ju!”

لَا قِطْعَانَ اِيْدِيْكُمْ وَاَرْجُلَكُمْ مِّنْ خِلَافٍ  
ثُمَّ لَا صَلْبِيْكُمْ اٰجْمَعِيْنَ ﴿٣٨﴾

126. Ata thanë: “Sigurisht, ne te Zoti ynë do të kthehemi.

قَالُوْا اِنَّا اِلَى رَبِّنَا مُنْقَلِبُوْنَ ﴿٣٩﴾

127. Dhe ti na qorton vetëm sepse kemi besuar shenjat e Zotit tonë, kur ato na erdhën! O Zoti ynë! Jepna durimin dhe jepna vdekje kur jemi të nënshtruar!”<sup>26</sup>

وَمَا تَنْقِمُ مِّنَّا اِلَّا اَنْ اٰمَنَّا بِآيٰتِ رَبِّنَا لَمَّا  
جَاءَتْنَا ؕ رَبَّنَا اَفْرِغْ عَلَيْنَا صَبْرًا وَّ تَوَفَّنَا  
مُسْلِمِيْنَ ﴿٤٠﴾

128. Prijësit nga populli i Faraonit thanë: “A do t’i lësh të lirë Musain dhe popullin e tij që të bëjnë çrregullime në tokë dhe të të braktisin ty dhe zotat e tu?” Ai u tha: “Ne do t’i vrasim keqas bijtë e tyre, kurse gratë e tyre do t’i mbajmë gjallë; dhe ne sigurisht jemi të plotfuqishëm mbi ta.”

وَقَالَ الْمَلَأُ مِنْ قَوْمِ فِرْعَوْنَ اٰتَدَّرُ  
مُوسٰى وَقَوْمَهُ لِيُفْسِدُوْا فِى الْاَرْضِ  
وَ يَدْرَكَ وَاِلِهَتِكَ ؕ قَالَ سَقِئِلُ  
اَبْنَاءِ هُمْ وَاَسْتَحٰى نِسَاءَهُمْ ؕ وَاِنَّا فَوْقَهُمْ  
قَاهِرُوْنَ ﴿٤١﴾

129. Musai i tha popullit të tij: “Kërkojini ndihmë Allahut dhe duroni! Toka pa dyshim është e Allahut. Ai ia trashëgon kujt të dojë nga robërit e Tij. Përfundimi u takon të druajturve (ndaj Zotit).”

قَالَ مُوسٰى لِقَوْمِهٖ اسْتَعِيْنُوْا بِاللّٰهِ  
وَاصْبِرُوْا ؕ اِنَّ الْاَرْضَ لِلّٰهِ ؕ يُؤْتِيْهَا مَنْ  
يَّشَآءُ مِنْ عِبَادِهٖ ؕ وَالْعَاقِبَةُ لِلْمُتَّقِيْنَ ﴿٤٢﴾

26. Këtu fjala është muslimanë, që do të thotë të nënshtruar ndaj Zotit.

130. Ata thanë: “Ne u lënduam edhe para se të vije ti, edhe pasi na erdhe.” (Musai) tha: “Mundet që Zoti juaj ta shkatërrojë armikun tuaj, do t’ju bëjë trashëgimtarë në tokë dhe më pas të shohë se si do të veproni ju.”<sup>27</sup>

131. Dhe Ne e zumë popullin e Faraonit me thatësira dhe me humbje të frutave, që ata të kuptonin.

132. Kur atyre u vinte mirësia, thoshin: “është e jona”, e kur i godiste ndonjë e keqe, i quanin Musain dhe shokët e tij si ogurkëqij. Dëgjoni! Oguri i tyre i keq është tek Allahu, por shumica prej tyre nuk e dinë!

133. Ata thanë: “Çfarëdo shenje të na sjellësh për të na magjepsur, ne nuk kemi për të të besuar ty.”

134. Atëherë, Ne dërguam përmbi ta shtrëngatën, karkalecat, morrat, bretkosat dhe gjakun si shenja më vete.<sup>28</sup> Prapë ata u treguan mendjemëdhenj dhe ata ishin popull fajtor.

135. Kur atyre u binte ndëshkimi, thoshin: “O Musa! Lutju Zotit tënd për ne, në saje të premtimit që Ai të ka

قَالُوا أُوذِينَا مِنْ قَبْلِ أَنْ تَأْتِيَنَا وَ مِنْ بَعْدِ مَا  
جِئْتَنَا ۗ قَالَ عَلَىٰ رَبِّكُمْ أَنْ يَهْلِكَ  
عَدُوُّكُمْ وَيَسْتَخْلِفَكُمْ فِي الْأَرْضِ فَيَنْظُرَ  
كَيْفَ تَعْمَلُونَ ﴿٢٧﴾

وَلَقَدْ أَخَذْنَا آلَ فِرْعَوْنَ بِالسِّنِينَ وَنَقِصِ  
مِنَ الثَّمَرَاتِ لَعَلَّهُمْ يَذَّكَّرُونَ ﴿٢٨﴾

فَإِذَا جَاءَتْهُمْ الْحَسَنَةُ قَالُوا لَنَا هَذِهِ ۗ وَإِنْ  
تُصِبْهُمْ سَيِّئَةٌ يَتَّخِذُوهَا بِمُوسَىٰ وَ مَنْ  
مَعَهُ ۗ آلَا إِنَّمَا ظَنَرَهُمْ عِنْدَ اللَّهِ وَ لَكِنَّ  
أَكْثَرَهُمْ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٢٩﴾

وَقَالُوا مَهْمَا تَأْتِنَا بِهِ مِنْ آيَةٍ لِنَسْحَرَنَّ بِهَا  
فَمَا نَحْنُ لَكَ بِمُؤْمِنِينَ ﴿٣٠﴾

فَأَرْسَلْنَا عَلَيْهِمُ الطُّوفَانَ وَ الْجَرَادَ وَ الْقُمَّلَ  
وَ الضَّفَادِعَ وَ الدَّمَ آيَاتٍ مُفْصَلَةٍ ۗ  
فَاسْتَكْبَرُوا وَ كَانُوا قَوْمًا مُجْرِمِينَ ﴿٣١﴾

وَلَمَّا وَقَعَ عَلَيْهِمُ الرِّجْزُ قَالُوا يُمُوسَىٰ  
ادْعُ لَنَا رَبَّكَ بِمَا عَهِدَ عِنْدَكَ ۗ لَئِن

27. Ajeti nuk do të thotë se izraelitët do ta trashëgonin Egjiptin pas shkatërrimit të Faraonit, por vetëm se fuqia e Faraonit do të thyhej dhe të tjerët do ta zotëronin mbretërinë e tij. Ne e dimë se pas shkatërrimit të Faraonit dhe të shpërbërjes së mbretërisë së tij, një dinasti tjetër, miqësore me izraelitët, sundoi vendin. “Toka” e përmendur në këtë ajet nuk i referohet Egjiptit, por Tokës së Shenjtë që u ishte premtuar izraelitëve dhe të cilën ata e trashëguan në përputhje me premtimin. Lexoni edhe 10:15.

28. Lexoni 27:13.

bërë ty; nëse na e largon ndëshkimin, patjetër do të të besojmë dhe do t'i nisim bijtë e Izraelit me ty.”

136. E kur e larguam ndëshkimin prej tyre për një afat që ishte i caktuar për ta, ata e shkelën premtimin.

137. Atëherë Ne u hakmorëm me ta. I fundosëm në det sepse ata i quajtën gënjeshtër shenjtarët Tona dhe ishin shpërfillës ndaj tyre.

138. Dhe popullit që cilësohej i dobët, Ne ia trashëguam pjesët lindore të tokës dhe ato perëndimore të saj, të cilat i kishim bekuar.<sup>29</sup> U përmbushën fjalët e bukura të Zotit tënd ndaj bijve të Izraelit, për shkak se ata duruan dhe Ne e shkatërruam atë që bënin Faraoni dhe populli i tij, si dhe kullat që ata ndërtonin.

139. Dhe i çuam bijtë e Izraelit matanë detit. Ata kaluan pranë një populli që rrinin përpara idhujve të tyre (duke i adhuruar). Ata thanë: “O Musa! Bëj edhe për ne një zot, sikurse këta kanë zota.” Ai tha: “Jeni një popull injorant!”

140. Gjendja në të cilën ata janë është shkatërrim dhe puna që bëjnë ata është e kotë.

كَشَفْتَا عَنْكَ الرِّجْزَ لَتُؤْمِنَنَّ لَكَ  
وَلَنُرْسِلَنَّ مَعَكَ بَنِي إِسْرَائِيلَ ﴿١٣٦﴾

فَلَمَّا كَشَفْنَا عَنْهُمْ الرِّجْزَ إِلَىٰ آجَلٍ هُم  
بِلُغْوِهِ إِذَا هُمْ يَنْكُثُونَ ﴿١٣٧﴾

فَأَنتَقَمْنَا مِنْهُمْ فَأَغْرَقْنَاهُمْ فِي الْيَمِّ  
بِأَنَّهُمْ كَذَّبُوا بِآيَاتِنَا وَكَانُوا عَنْهَا غَافِلِينَ ﴿١٣٨﴾

وَأَوْرَثْنَا الْقَوْمَ الَّذِينَ كَانُوا يُسْتَضَعُونَ  
مَشَارِقَ الْأَرْضِ وَمَعَارِبَهَا الَّتِي بَرَكْنَا  
فِيهَا ۗ وَتَمَّتْ كَلِمَتُ رَبِّكَ الْحُسْنَىٰ عَلَىٰ  
بَنِي إِسْرَائِيلَ ۚ بِمَا صَبَرُوا ۗ وَدَمَّرْنَا مَا كَانَ  
يَصْنَعُ فِرْعَوْنُ وَقَوْمُهُ وَمَا كَانُوا يَعْرِشُونَ ﴿١٣٩﴾

وَجَوْرَتَنَا لَبِئْسَ بَنِي إِسْرَائِيلَ الْبَحْرَ فَأَتَوْا عَلَىٰ  
قَوْمٍ يَعْكُفُونَ عَلَىٰ أَصْنَانِهِمْ ۗ قَالُوا  
يُمُوسَىٰ اجْعَلْ لَنَا إِلَهًا كَمَا لَهُمْ آلِهَةٌ ۗ  
قَالَ إِنَّكُمْ قَوْمٌ تَجْهَلُونَ ﴿١٤٠﴾

إِنَّ هَؤُلَاءِ مُتَّبِعُونَ مَا هُم بِفِيهِ ۗ وَيُطَّلَمُونَ  
كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿١٤١﴾

29. Sipas frazeologjisë arabe, fjalët “pjesët lindore të tokës dhe ato perëndimore të saj” gjithashtu nënkuptojnë mbarë vendin. Toka e Shenjtë është ajo që u ishte premtuar pasardhësve të Ibrahimit<sup>as</sup> dhe të Jakubit<sup>as</sup> (5:22). Ajo ishte e bekuar sepse do të ishte vendi ku izraelitët do të lulëzonin, do të gëzonin prosperitetin dhe do të bëheshin një komb i madh.

141. Ai tha: “A të kërkoj ndonjë zot tjetër përveç Allahut për ju, edhe pse është Ai që ju ka dhënë epërsi mbi botët?!”

قَالَ أَعْبُدِ اللَّهَ أَنْبِئِكُمْ إِلَهًا وَهُوَ فَضَّلَكُمْ  
عَلَى الْعَالَمِينَ ﴿١٤١﴾

142. Dhe (kujtojeni) kur ju shpëtua nga populli i Faraonit, të cilët ju sflitnin me ndëshkim të keq, vrisnin bijtë tuaj, kurse gratë tuaja i mbanin gjallë. Kjo ishte një sprovë shumë e madhe nga Zoti juaj.

وَإِذْ أَنْجَبْنَاكُمْ مِنْ آلِ فِرْعَوْنَ يَسُومُونَكُمْ  
سُوءَ الْعَذَابِ يُقْتُلُونَ أَبْنَاءَكُمْ  
وَيَسْتَحْيُونَ نِسَاءَكُمْ ۗ وَفِي ذُرِّيَّتِكُمْ بَلَاءٌ  
كَبِيرٌ ۖ مِنْ رَبِّكُمْ عَظِيمٌ ﴿١٤٢﴾

143. Dhe Ne i premtuam Musait tridhjetë net dhe i përsosëm ato me dhjetë (të tjera), kështu, u përsos caktimi i Zotit të tij për dyzet net. Musai i tha vëllait të tij, Harunit: “Më zëvendëso te populli im, përmirëso dhe mos ndiq rrugën e çrregulluesve.”

وَوَعَدْنَا مُوسَى ثَلَاثِينَ لَيْلَةً وَأَتَمَّمْنَاهَا  
بِحَشْرِ فِئْتَمِّ مِيقَاتِ رَبِّهِ ۗ أَرْبَعِينَ لَيْلَةً  
وَقَالَ مُوسَى لِأَخِيهِ هَارُونَ اخْلُفْنِي فِي  
قَوْمِي وَأَصْلِحْ وَلَا تَتَّبِعْ سَبِيلَ  
الْمُفْسِدِينَ ﴿١٤٣﴾

144. Kur Musai erdhi në kohën që e kishim caktuar dhe i foli Zoti i tij, ai tha: “O Zoti im! Dukmu që unë të Të shoh.” (Zoti) tha: “Nuk mund të Më shohësh Mua, por shikoje malin; nëse ai qëndron në vendin e vet, atëherë edhe ti do të më shohësh Mua.” E kur Zoti i Tij iu manifestua malit, Ai e bëri copë-copë, dhe Musai ra pa ndjenja. Kur e mori veten, tha: “I Shenjtë je Ti; vij i penduar drejt Teje dhe Jam i pari i besimtarëve.”<sup>30</sup>

وَلَمَّا جَاءَ مُوسَى لِمِيقَاتِنَا وَكَلَّمَهُ رَبُّهُ  
قَالَ رَبِّ ارْنِنِّي أَنْظُرَ إِلَيْكَ ۗ قَالَ لَنْ  
تَرِنِنِّي وَلَكِنِ انظُرْ إِلَى الْجَبَلِ فَإِنِ اسْتَقَرَّ  
مَكَانَهُ فَسَوْفَ تَرِنِنِّي ۗ فَلَمَّا تَجَلَّى رَبُّهُ  
لِلْجَبَلِ جَعَلَهُ دَكًّا وَخَرَّ مُوسَى صَعِقًا  
فَلَمَّا أَفَاقَ قَالَ سُبْحَانَكَ تُبْتُ إِلَيْكَ  
وَأَنَا أَوَّلُ الْمُؤْمِنِينَ ﴿١٤٤﴾

30. Ajeti flet për rënien pa ndjenja të Hazret Musait<sup>as</sup>, dhe kjo ngjarje është me dimensionin shpirtëror, të cilën e shkaktoi jo ndonjë errësirë tokësore e tij, por manifestimet etribute të Allahut që atij iu shfaqën me një dritë të jashtëzakonshme. Ishin pikërisht këto manifestime që kur u shfaqën në mënyrë të fuqishme, e detyruan robin e Allahut të rrezohej pa ndjenja. Bujaria e Allahut e ngriti sërish Hazret Musain<sup>as</sup>. Por, kjo nuk është grada më e lartë e zhvillimit shpirtëror. Grada më e lartë është ajo që përmendet për Profetin Muhammed<sup>savs</sup> në Kuran: “Shikimi as nuk pati shtrembërim, as nuk e teproi” (53:18).

145. Ai tha: O Musa! Unë të kam dhënë epërsi mbi të gjithë njerëzit përmes mesazheve të Mia dhe fjalës Sime. Andaj, mbaje atë që të kam dhënë dhe bëhu ndër mirënjohësit.

قَالَ يٰمُوسَىٰ اِنِّىٓ اصْطَفَيْتَكَ عَلَىٰ النَّاسِ  
بِرِسَالَتِي وَاِبْرٰٓءِىٓ فَخُذْ مَا اٰتٰىتَكَ وَكُنْ  
مِنَ الشَّاكِرِيْنَ ﴿١٤٥﴾

146. Dhe Ne i kemi shkruar çdo gjë në pllaka si këshillë dhe shpjegim për çdo gjë. Andaj, mbaje fuqishëm dhe urdhëro popullin tënd që të mbajnë më të mirën e saj. Së shpejti do t'ju tregoj (edhe) shtëpinë e të pabindurve.

وَكَتَبْنَا لَهُ فِى الْاَلْوَاخِ مِنْ كُلِّ شَيْءٍ  
مُّوَعِّظَةً وَتَفْصِيْلًا لِّكُلِّ شَيْءٍ ۚ فَخُذْهَا  
بِقُوَّةٍ وَّامْرُؤًا قَوْمَكَ يٰاٰخُذُوْا بِحَسَنٰٓهَا  
سٰوْرِىْكُمْ دَارَ الْفٰسِقِيْنَ ﴿١٤٦﴾

147. Ata që bëhen mendjemëdhenj në tokë pa të drejtë, Unë do t'i largoj nga shenjat e Mia. Edhe sikur të shohin çdo shenjë, nuk do ta besojnë atë. Nëse shohin rrugën e drejtë, nuk e marrin atë si rrugë. E nëse shohin rrugën e shtrembër, atë e marrin si rrugë. Kjo ndodh për shkak se ata i quajtën gënjeshtër shenjat Tona dhe i shpërfillnin.

سٰٓصْرُفٌ عَنِ اٰیٰتِىۤ الَّذِيْنَ يَتَكَبَّرُوْنَ فِى  
الْاَرْضِ بِغَيْرِ الْحَقِّ ۗ وَاِنْ يَّرَوْا كُلَّ اٰیَةٍ  
لَّا يُؤْمِنُوْا بِهَا ۗ وَاِنْ يَّرَوْا سَبِيْلَ الرُّشْدِ  
لَّا يَتَّخِذُوْهُ سَبِيْلًا ۗ وَاِنْ يَّرَوْا سَبِيْلَ الْغٰى  
يَتَّخِذُوْهُ سَبِيْلًا ۗ ذٰلِكَ بِاَنَّهُمْ كَذَّبُوْا  
بِاٰیٰتِنَا وَاكٰثَرُوْا عَنْهَا غٰفِلِيْنَ ﴿١٤٧﴾

148. Ata që i quajtën gënjeshtër shenjat Tona si dhe takimin e *ahiretit*, veprat e tyre dështuan. A nuk do të shpërblehen ata vetëm për atë çka bënin?!

وَالَّذِيْنَ كَذَّبُوْا بِاٰیٰتِنَا وَّلَقَاءِ الْاٰخِرَةِ  
حٰطِطَتْ اَعْمَالُهُمْ ۗ هَلْ يُجْرَوْنَ اِلَّا مَا  
كَانُوْا يَعْمَلُوْنَ ﴿١٤٨﴾

149. Prapa tij, populli i Musait, prej stolive të tyre morën (për adhurim) një viç, një trup (të pajetë) që pëlliste. A nuk e panë se ai as nuk u fliste e as nuk u tregonte udhë?! Ata e morën (për Zot) dhe ishin të padrejtë.

وَاتَّخَذَ قَوْمُ مُوسٰى مِنْۢ بَعْدِهِ مِنْ حٰٓئِيْهِمْ  
عِبٰٓلًا جَسَدًا لِّلّٰهِ خَوٰرٌ ۗ اَلَمْ يَرَوْا اَنَّهُ  
لَا يَكْلِمُهُمْ وَلَا يَهْدِيْهِمْ سَبِيْلًا ۗ اِتَّخَذُوْهُ  
وَاكٰثَرُوْا ظٰلِمِيْنَ ﴿١٤٩﴾



150. E kur ranë të penduar dhe panë që ishin të humbur, thanë: “Nëse nuk na mëshiron Zoti ynë dhe nëse nuk na fal Ai, ne me siguri do të jemi humbës.”

وَلَمَّا سَقَطَ فِي أَيْدِيهِمْ وَرَأَوْا أَنَّهُمْ قَدْ  
صَلُّوا قَالُوا لَئِن لَّمْ يَرْحَمْنَا رَبُّنَا وَيَغْفِرْنَا  
لَنَكُونَنَّ مِنَ الْخَاسِرِينَ ﴿١٥٠﴾

151. Kur Musai u kthye te populli i tij, i zemëruar dhe i pikëlluar, tha: “Sa keq më keni përfaqësuar prapa meje! A nxituat në lidhje me porosinë e Zotit tuaj?!” Ai i hodhi (përtokë) pllakat dhe e kapi vëllain e tij për koke, duke e tërhequr nga vetja. (Vëllai) i tha: “O bir i nënës sime! Populli më bëri të pafuqishëm dhe gati do të më vriste, andaj, mos më bëj shkak të talljes së armiqve dhe mos më llogarit me popullin keqbërës.”<sup>31</sup>

وَلَمَّا رَجَعَ مُوسَى إِلَى قَوْمِهِ غَضْبَانَ  
أَسْفًا قَالَ بِنُسْمَا خَلَفْتُمُونِي مِنْ بَعْدِي  
أَعَجَلْتُمْ أَمْرَ رَبِّكُمْ ؕ وَالْقَى الْأُلُوْحَ  
وَآخَذَ بِرَأْسِ أَخِيهِ يَجُرُّهُ إِلَيْهِ ؕ قَالَ  
ابْنَ أُمَّ إِنَّ الْقَوْمَ اسْتَضَعَفُونِي وَكَادُوا  
يَقْتُلُونَنِي ؕ فَلَا تُشِمْتِ بِي الْأَعْدَاءَ وَلَا  
تَجْعَلْنِي مَعَ الْقَوْمِ الظَّالِمِينَ ﴿١٥١﴾

152. (Musai) tha: “O Zoti im! Më fal mua dhe vëllain tim dhe na prano në mëshirën Tënde. Ti je më i mëshirshmi nga të gjithë mëshiruesit.”

قَالَ رَبِّ اغْفِرْ لِي وَ لِأَخِي وَادْخُلْنَا فِي  
رَحْمَتِكَ ۗ وَأَنْتَ أَرْحَمُ الرَّحِيمِينَ ﴿١٥٢﴾

153. Sigurisht, ata që morën vëllain (për Zot), do t'i zërë zemërimi prej Zotit të tyre, si dhe poshtërimi në jetën e kësaj bote. Ne kështu i shpërblejmë shpifësit!

إِنَّ الَّذِينَ اتَّخَذُوا الْعِجْلَ سَيبَأَهُمْ غَضَبٌ  
مِّن رَّبِّهِمْ وَذِلَّةٌ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا  
وَكَذَلِكَ نَجْزِي الْمُفْتِرِينَ ﴿١٥٣﴾

154. Ata që bënë të këqija dhe pas kësaj u penduan dhe besuan, Zoti yt (edhe) pas kësaj është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

وَالَّذِينَ عَمِلُوا السَّيِّئَاتِ ثُمَّ تَابُوا مِنْ بَعْدِهَا  
وَآمَنُوا ۗ إِنَّ رَبَّكَ مِنْ بَعْدِهَا لَغَفُورٌ  
رَّحِيمٌ ﴿١٥٤﴾

31. Hazret Musai<sup>as</sup> e kapi Harunin<sup>as</sup> për koke, jo sepse ky i fundit kishte predikuar a mbështetur adhurimin e vëllit, siç pohohet në Bibël (Eksodi 32:2-4), por sepse nuk i ndaloi dot me sukses njerëzit të adhuronin vëllin. Zemërimi i Hazret Musait<sup>as</sup> ishte i justifikuar sepse e gjithë puna tij ishte vënë në rrezik.

155. Kur Musait i kaloi zemërimi, i mori pllakat. Në shënimet e tyre kishte udhëzim dhe mëshirë për ata që i frikësoheshin Zotit të tyre.

156. Musai zgjodhi shtatëdhjetë burra nga populli i tij për kohën e caktuar nga Ne. E kur ata i zuri tërmeti, ai tha: “O Zoti im! Po të doje, do t'i shkatërroje ata dhe mua që përpara. A do të na shkatërrosh për shkak të asaj që bënë mendjelehtët prej nesh? Pa dyshim, kjo është vetëm një sprovë nga Ti. Përmes kësaj Ti devijon kë të duash dhe udhëzon kë të duash. Ti je Miku ynë! Andaj, na fal dhe na mëshiro dhe Ti je Falësi më i mirë!

157. Dhe na shëno mirësi edhe në këtë botë, edhe në *ahiret*. Ne te Ti kemi ardhur (duke u penduar).” (Zoti) tha: Kë të dua Unë e godas me ndëshkimin Tim, kurse mëshira Ime përfshin çdo gjë, andaj, atë do ta caktoj (në veçanti) për ata që druhen (ndaj Meje), japin zekatin dhe që i besojnë shenjat Tona.

158. Të cilët ndjekin të Dërguarin, Profetin e pashkolluar, të cilin e gjejnë të shkruar pranë tyre në Teurat dhe në Inxhil,<sup>32</sup> ai i urdhëron për të drejtën, ndalon nga ligësia, u lejon të pastrat, u ndalon të ndytat dhe ua heq barrën dhe zgjedhat që

وَلَمَّا سَكَتَ عَنْ مُوسَى الْغَضَبَ أَخَذَ  
الْأُلُوحَ ۗ وَفِي نُسُخِهَا هُدًى وَرَحْمَةٌ  
لِّلَّذِينَ هُمْ لِرَبِّهِمْ يَرْتَبُونَ ﴿١٥٥﴾

وَاخْتَارَ مُوسَى قَوْمَهُ سَبْعِينَ رَجُلًا  
لِّمِيقَاتِنَا ۗ فَلَمَّا أَخَذَتْهُمُ الرَّجْفَةُ قَالَ  
رَبِّ لَوْ شِئْتَ أَهْلَكْتَهُم مِّن قَبْلُ  
وَإِيَّاي ۗ أَتُهْلِكُنَا بِمَا فَعَلَ السَّمْعَاءُ مِنَّا  
إِن هِيَ إِلَّا فِتْنَتُكَ ۗ تُضِلُّ بِهَا مَن تَشَاءُ  
وَتَهْدِي مَن تَشَاءُ ۗ أَنْتَ وَلِيُّنَا فَاغْفِرْ لَنَا  
وَارْحَمْنَا ۗ وَأَنْتَ خَيْرُ الْغَافِرِينَ ﴿١٥٦﴾

وَكَتُبْنَا لَنَا فِي هَذِهِ الدُّنْيَا حَسَنَةً وَفِي  
الْآخِرَةِ إِنَّا هُنَا أَعْيُنٌ عَادِيٌّ  
أَصِيبُ بِهِ مَن أَشَاءُ ۗ وَرَحِمْتِي  
وَسِعَتْ كُلَّ شَيْءٍ ۗ فَسَاكُتُهَا لِّلَّذِينَ  
يَتَّقُونَ وَيُؤْتُونَ الزَّكَاةَ وَالَّذِينَ هُمْ  
بِآيَاتِنَا يُؤْمِنُونَ ﴿١٥٧﴾

الَّذِينَ يَتَّبِعُونَ الرَّسُولَ النَّبِيَّ الْأُمِّيَّ  
الَّذِي يَجِدُونَهُ مَكْتُوبًا عِنْدَهُمْ فِي  
التَّوْرَةِ وَالْإِنْجِيلِ ۗ يَأْمُرُهُم بِالْمَعْرُوفِ  
وَيَنْهَاهُمْ عَنِ الْمُنْكَرِ وَيَجْلُسُ لَهُمُ  
الطَّيِّبَاتِ وَيُحَرِّمُ عَلَيْهِمُ الْخَبِيثَاتِ وَيَضَعُ

32. Për disa nga profecitë e Biblës për Profetin Muhammed<sup>saws</sup>, shikoni: Ligji i Përtërirë 18:18 dhe 33:2; Isaia 21:13-17 dhe 62:2; Mateu 23:39; Gjoni 14:16, 26; 16:7-14.

ata i kishin përmbi vete. Andaj, ata që e besuan, e nderuan, e ndihmuan dhe ndoqën dritën që zbriti me të, janë të suksesshmit.<sup>33</sup>

عَنْهُمْ إِصْرَهُمْ وَالْأَعْلَالَ الَّتِي كَانَتْ عَلَيْهِمْ ۗ فَالَّذِينَ آمَنُوا بِهِ وَعَزَّرُوهُ وَنَصَرُوهُ وَاتَّبَعُوا النُّورَ الَّذِي أُنزِلَ مَعَهُ ۗ أُولَٰئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ ﴿٣٣﴾

159. Thuaju: O njerëz! Sigurisht, unë jam i Dërguari i Allahut për ju të gjithë, i Atij që ka sundimin e qiejve dhe të tokës. Nuk ka të adhurueshëm tjetër përveç Atij. Ai jep jetë dhe vdekje. Andaj, besojeni Allahun, të Dërguarin e Tij, Profetin e pashkolluar, i cili beson Allahun dhe engjëjt e Tij, dhe ndiqeni atë, në mënyrë që të udhëzoheni.<sup>34</sup>

قُلْ يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنِّي رَسُولُ اللَّهِ إِلَيْكُمْ جَمِيعًا ۗ الَّذِي لَهُ مُلْكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ۗ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ يُحْيِي وَيُمِيتُ ۗ فَآمِنُوا بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ النَّبِيِّ الْأَخِي الَّذِي يُؤْمِنُ بِاللَّهِ وَكَلِمَاتِهِ وَاتَّبِعُوهُ لَعَلَّكُمْ تَهْتَدُونَ ﴿٣٤﴾

160. Edhe në popullin e Musait ishin njerëz (që) udhëzonin me të vërtetën dhe përmes saj bënin drejtësi.

وَمِنْ قَوْمِ مُوسَى أُمَّةٌ يَهْتَدُونَ بِالْحَقِّ وَبِهِ يَعْدِلُونَ ﴿٣٥﴾

161. Dhe Ne i ndamë ata në dymbëdhjetë fise, popuj. Musait, kur populli i tij i kërkoi ujë, i shpallëm:

وَقَطَّعْنَاهُمْ اثْنَتَيْ عَشْرَةَ أَسْبَاطًا أُمَمًا ۗ وَأَوْحَيْنَا إِلَىٰ مُوسَىٰ إِذِ اسْتَسْقَاهُ قَوْمَهُ

33. Profetin Muhammed<sup>saws</sup> e shoqërojnë dy nga shenjat madhështore të Zotit. Njëra prej tyre janë profecitë në lidhje me ardhjen e tij që gjenden në Teurat dhe në Inxhil, dhe e dyta është forca e qenësishme e vetë Profetit, i cili pavarësisht se është i pashkolluar, ka sjellë udhërrëfyesin e përsosur për të porositur të gjitha të vërtetat që logjika njerëzore i pranon, por që ishin zhdukur nga faqja e dheut, dhe për të ndaluar nga çdo ligësi a devijim, që edhe logjika njerëzore e hedh poshtë. Pra, udhërrëfyesi i tij i cilëson gjërat e pastra si të pastra dhe ato të papastra si të papastra, dhe po kështu, ua liron barrët hebrejve dhe të krishterëve, të cilat i kanë rënduar tej mase. Andaj, ata që e besojnë këtë Profet, e fuqizojnë dhe e ndihmojnë atë dhe ndjekin me përkushtim dritën e tij, janë të suksesshëm.

34. Vetëm Kurani i Shenjtë deklaron hapur se ai është për mbarë njerëzimin dhe Profeti që e solli atë është për të gjithë popujt. Diku tjetër në Kuran pohohet: “Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty, përveçse si mëshirë për botët” (21:108) “... që ai të jetë alarmues për të gjitha botët” (25:2). Asnjë nga Librat Hyjnorë përpara Kuranit nuk deklaroi të ishte për të gjithë popujt e botës. Andaj, Profeti Muhammed<sup>saws</sup> u dërgua si Profet jo vetëm për arabët, por për të gjitha kombet, dhe jo vetëm për të pashkolluarit, por për çdo shtresë të njerëzimit. Shkurt, Kurani i Shenjtë erdhi si Libër Hyjnor për të dritësuar aftësitë e çdo njeriu.

“Bjeri shkëmbit me shkopin tënd!”  
Atëherë prej tij rrodhën dymbëdhjetë burime. Gjithsecili mësoi burimin e vet. U bëmë hije me re dhe u zbritëm *manën* dhe *selvanë*: Hani të pastrat nga ato që ju kemi dhënë. Dhe ata nuk Na bënë keq Neve, por vetëm vetvetes i bënë keq.<sup>35</sup>

162. Dhe (kujtoni) kur atyre u ishte thënë: “Banoni në këtë qytet, hani nga të doni prej tij, thoni *hit-tatun* (d.m.th. na fal) dhe hyni të nënshtruar nga porta, Ne do t’juja falim gabimet tuaja. Ne patjetër do t’i shtojmë mirëbërësit.”

163. Ndër ata që kishin bërë padrejtësi, (këtë e) ndërruan me një fjalë tjetër, e cila nuk u ishte thënë. Atëherë u dërguam ndëshkim prej qiellit për shkak të padrejtësisë që bënë.

164. Pyeti rreth qytetit që gjendej në breg të detit. Kur ata (pra, banorët e qytetit) e tepronin në lidhje me *sabatin*; kur peshqit e tyre u vinin tufa-tufa ditën e *sabatit* të tyre, dhe ditën kur ata nuk e bënë *sabatin*, nuk u vinin. Kështu i sprovonim, sepse ata tregoheshin të pabindshëm.

165. Kur një grup prej tyre tha: “Përse këshilloni një popull, të cilin Allahu ka për ta shkatërruar ose ka

أَنْ أَصْرَبُ بِعَصَاكَ الْحَجَرَ ۗ فَانْبَجَسَتْ  
مِنْهُ اثْنَتَا عَشْرَةَ عَيْنًا ۗ قَدْ عَلِمَ كُلُّ أُنَاسٍ  
مَشْرَبَهُمْ ۗ وَظَلَّلْنَا عَلَيْهِمُ الْغَمَامَ وَأَنْزَلْنَا  
عَلَيْهِمُ الْمَنَّانَ وَالسَّلْوَىٰ ۗ كُلُّوا مِنْ طَيِّبَاتِ  
مَا رَزَقْنَاكُمْ ۗ وَمَا ظَلَمُونَا وَلَكِنْ كَانُوا  
أَنْفُسَهُمْ يَظْلِمُونَ ﴿١٦٢﴾

وَإِذْ قِيلَ لَهُمْ اسْكُنُوا هَذِهِ الْقَرْيَةَ وَكُلُوا  
مِنْهَا حَيْثُ شِئْتُمْ وَقُولُوا حِطَّةٌ وَادْخُلُوا  
الْبَابَ سَجِدًا نَّعْفِرْكُمْ خَطِيئَتِكُمْ  
سَنَزِيدُ الْمُحْسِنِينَ ﴿١٦٣﴾

فَبَدَّلَ الَّذِينَ ظَلَمُوا مِنْهُمْ قَوْلًا غَيْرَ  
الَّذِي قِيلَ لَهُمْ فَأَرْسَلْنَا عَلَيْهِمْ رِجْزًا  
مِّنَ السَّمَاءِ بِمَا كَانُوا يَظْلِمُونَ ﴿١٦٤﴾

وَسَأَلَهُمْ عَنِ الْقَرْيَةِ الَّتِي كَانَتْ حَاصِرَةً  
الْبَحْرِ ۗ إِذْ يَعْدُونَ فِي السَّبْتِ إِذْ تَأْتِيهِمْ  
حَيْثَانَهُمْ يَوْمَ سَبْتِهِمْ شُرْعًا وَ يَوْمَ  
لَا يَسْتَيْتُونَ ۗ لَا تَأْتِيهِمْ ۗ كَذَلِكَ نَبْلُوهُمْ  
بِمَا كَانُوا يَفْسُقُونَ ﴿١٦٥﴾

وَإِذْ قَالَتْ أُمَّةٌ مِنْهُمْ لِمَ تَعِظُونَ قَوْمًا  
اللَّهُ مُهْلِكُهُمْ أَوْ مُعَدِّبُهُمْ عَذَابًا شَدِيدًا ۗ

35. Për *manën* dhe *selvanë*, lexoni 2:58.

për ta dënuar me një ndëshkim të rëndë?” Ata thanë: “Si shfajësim te Zoti juaj dhe që ata të kenë drojë (ndaj Zotit).”

166. E kur ata e harruan atë për të cilën ishin këshilluar, Ne i shpëtuam ata që ndalonin nga e keqja, kurse ata që bënëin padrejtësi, i zumë me një ndëshkim të rëndë për shkak të ligësive që bënëin.

167. E kur ata u treguan të pabindshëm ndaj asaj që u ishte ndaluar, Ne u thamë: “Bëhuni majmunë të poshtër!”<sup>36</sup>

168. Dhe (kujto) kur Zoti yt njoftoi se Ai patjetër do të caktojë përmbi ta deri në Ditën e Kiametit (njerëz) që do t'i dënojnë me ndëshkim të keq. Sigurisht, Zoti yt është shumë i Shpejtë në ndëshkim dhe sigurisht, Ai është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

169. Ne i shpërndamë ata në popuj nëpër tokë. Prej tyre kishte të sinqertë dhe po prej tyre kishte edhe të tjerë ndryshe nga ata. I sprovuam me të mira e me të këqija, në mënyrë që ata të ktheheshin (në rrugën e drejtë).

170. Pas tyre i pasuan mëkëmbës që e trashëguan Librin; ata merrnin plaçkën e kësaj (bote) të ulët dhe thoshin: “Do të na falet”. Kur u vinte një plaçkë e ngjashme si ajo, e merrnin (edhe) atë. A nuk ishte

قَالُوا مَعذِرَةٌ إِلَىٰ رَبِّكُمْ وَلَعَلَّهُمْ  
يَتَّقُونَ ﴿١٦٥﴾

فَلَمَّا نَسُوا مَا ذُكِّرُوا بِهِ أَنجَيْنَا الَّذِينَ  
يَهُونَ عَنِ السُّوءِ وَأَخَذْنَا الَّذِينَ ظَلَمُوا  
بِعَذَابٍ بَیِّنٍ بِمَا كَانُوا يَفْسُقُونَ ﴿١٦٦﴾

فَلَمَّا عَتَوْا عَن مَّا نُهَوَّا عَنْهُ قُلْنَا لَهُمْ  
كُونُوا قِرَدَةً خَاسِئِينَ ﴿١٦٧﴾

وَإِذ تَأَذَّنَ رَبُّكَ لِيُبْعَثَنَّ عَلَيْهِمْ إِلَىٰ يَوْمِ  
الْقِيَامَةِ مَن يَسُومُهُمْ سُوءَ الْعَذَابِ ۗ إِنَّ  
رَبَّكَ لَسَرِيعُ الْعِقَابِ ۗ وَإِنَّهُ لَغَفُورٌ  
رَّحِيمٌ ﴿١٦٨﴾

وَقَضَّاهُمْ فِي الْأَرْضِ أُمَّمًا مِّنْهُمْ  
الضَّالِّحُونَ وَمِنْهُمْ دُونَ ذَلِكَ ۗ وَبَلَّوْنَهُمْ  
بِالْحَسَنَاتِ وَالسَّيِّئَاتِ لَعَلَّهُمْ يَرْجِعُونَ ﴿١٦٩﴾

فَخَلَفَ مِنْ بَعْدِهِمْ خَلْفٌ وَرِثُوا الْكِتَابَ  
يَأْخُذُونَ عَرَصَ هَذَا الْأَدْنَىٰ وَيَقُولُونَ  
سَيَغْفِرَ لَنَا ۗ وَإِن يَأْتِهِمْ عَرَصٌ مِّثْلَهُ  
يَأْخُذُوهُ ۗ أَلَمْ يُؤْخَذْ عَلَيْهِمْ مِيثَاقُ الْكِتَابِ

36. Lexoni 2:66.

marrë prej tyre besëlidhja e Librit që të mos thoshin për Allahun asgjë përveç së vërtetës dhe ata e kishin studiuar çfarë kishte në të?! Shtëpia e fundit është e atyre që kanë drojë (ndaj Zotit). A nuk kuptoni?!

171. Për sa u përket atyre që i përmbahen Librit dhe falin namazin, sigurisht, Ne nuk e humbim shpërblimin e përmirësuesve.

172. Dhe (kujtoni) kur lartësua malin përmbi ta, sikur ai të ishte një strehë, dhe ata menduan se po u binte. “(O bijtë e Izraelit!) Kapeni fuqimisht atë që ju kemi dhënë dhe mbajeni mend atë çfarë ka në të, që të keni drojë (ndaj Zotit).”<sup>37</sup>

173. Dhe (kujtoni) kur Zoti yt mori pasardhësit e tyre nga bijtë e Ademit, nga kurrizi i tyre, dhe i bëri të dëshmojnë mbi vetveten (duke pyetur): “A nuk jam Zoti juaj?” Ata thanë: “Po, ne dëshmuam”. Që të mos thoni Ditën e Kiametit: “Kemi qenë të pavetëdijsëm për këtë!”<sup>38</sup>

37. Lexoni 2:64.

38. Bijve të Ademit përpara se ata të lindnin iu mor betimi që ata të dëshmonin ekzistencën e Zotit të Madhërisëm. Po si mund të merrej betimi nga njerëzit që ende nuk kishin lindur? Zoti i Madhërisëm paraqet në formë tregimi vetinë që Ai ka lënë në shpirtat, në gjenezën e tyre, dhe sipas kësaj vetie asnjë shpirt nuk mund ta mohojë Zotin. Kurse ata që e mohojnë, e mohojnë për shkak se nuk gjejnë ndonjë argument të ekzistencës së Tij sipas mendimit të tyre. Por pavarësisht nga mohimi, ata besojnë se çdo gjë që është e krijuar, ka nevojë për një krijues. Nuk ka njeri në botë me mendje të shëndoshë, që kur i shfaqet ndonjë sëmundje në trup, të ngulmojë se ajo i ka dalë pa asnjë shkak. I gjithë ky sistem po të mos ishte i lidhur me një zinxhir shkak-pasojë, do të ishte e pamundur të parashikonim kohën e përmbytjeve ose të tornadove, të eklipseve diellore ose hënore; do të ishte e pamundur të thoshim se pas kaq kohe ky i sëmurë do të vdesë, ose pasi kalon kaq kohë me këtë sëmundje, ai do të ketë sëmundjen tjetër, etj.. Kështu që, një studiues i tillë që pavarësisht se nuk beson në Zot, në një farë mënyre

أَنْ لَا يَقُولُوا عَلَى اللَّهِ إِلَّا الْحَقَّ وَدَرَسُوا  
مَا فِيهِ وَالذَّارُ الْآخِرَةُ حَيْرٌ لِلَّذِينَ  
يَسْتَفْتُونَ أَفَلَا تَعْقِلُونَ ﴿٣٧﴾

وَالَّذِينَ يُؤْتُونَ بِالْكِتَابِ وَآقَامُوا  
الصَّلَاةَ إِنَّا لَا نُنْصِغُ أَجْرَ الْمُصْلِحِينَ ﴿٣٨﴾

وَإِذْ تَتَقْنَا الْجَبَلَ فَوْقَهُمْ كَأَنَّهُ ظُلَّةٌ  
وَوَضَّوْا إِلَيْهِ وَاقَعَ بِهِمْ حَدُومًا مَا آتَيْنَاكُمْ  
بِقُوَّةٍ وَأَذْكُرُوا مَا فِيهِ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ ﴿٣٧﴾

وَإِذْ أَخَذَ رَبُّكَ مِنْ بَنِي آدَمَ مِنْ  
ظُهُورِهِمْ ذُرِّيَّتَهُمْ وَأَشْهَدَهُمْ عَلَى  
أَنْفُسِهِمْ أَلَسْتُ بِرَبِّكُمْ قَالُوا بَلَى  
شَهِدْنَا أَنْ تَقُولُوا يَوْمَ الْقِيَامَةِ إِنَّا كُنَّا  
عَنْ هَذَا غَافِلِينَ ﴿٣٨﴾

174. Ose të thoni: “Etërit tanë i atribuuan më parë ortakë (Allahut) dhe ne jemi një brez pas tyre, ndaj, a do të na shkatërrosh ne për shkak të asaj që kanë bërë gënjeshtarët?!”

175. Kështu i shtjellojmë ajetet dhe ndoshta ata kthehen (drejt së vërtetës).

176. Lexoju atyre lajmin e atij që i dhamë shenjat Tona, kurse ai doli jashtë tyre. Atë e ndoqi djalli dhe kështu u bë ndër të devijuarit.

177. Po të donim, do ta ngrinim me to, por aianoi nga toka dhe ndoqi dëshirën e vet. Ndaj, shembulli i tij është si shembulli i qenit: nëse e sulmon, nxjerr gjuhën, nëse e lë, nxjerr gjuhën. Ky është shembulli i popullit që i quajnë gënjeshtër shenjat Tona. Andaj, rrëfeju këto histori, që ndoshta reflektojnë.<sup>39</sup>

178. Sa i keq është shembulli i popullit që i quajtën gënjeshtër ajetet Tona dhe ata vetvetes i bënë keq.

أَوْ تَقُولُوا إِنَّمَا أَشْرَكَ آبَاؤُنَا مِنْ قَبْلُ  
وَكُنَّا ذُرِّيَّةً مِنْ بَعْدِهِمْ ۖ أَفَتُهْلِكُنَا  
بِمَا فَعَلَ الْمُبْطِلُونَ ﴿٧٤﴾

وَكَذَلِكَ نَقُصِّلُ الْآيَاتِ وَلَعَلَّهُمْ  
يَرْجِعُونَ ﴿٧٥﴾

وَإِثْلَ عَلَيْهِمْ بَأُ الدِّيَارِ اتَيْنَهُ ابْتِنَا فَا نَسَلَخَ  
مِنْهَا فَا تَبَعَهُ الشَّيْطَانُ فَكَانَ مِنَ  
الْغَوِيْنَ ﴿٧٦﴾

وَلَوْ شِئْنَا لَرَفَعْنَاهُ بِهَا وَلَكِنَّهُ أَخْلَدَ إِلَى  
الْأَرْضِ وَاتَّبَعَ هُوَهُ ۖ فَمَثَلُهُ كَمَثَلِ  
الْكَلْبِ ۖ إِنْ تَحَمَّلَ عَلَيْهِ يَلْهَثُ أَوْ تَتْرَكَهُ  
يَلْهَثُ ۗ ذَلِكَ مَثَلُ الْقَوْمِ الَّذِينَ كَذَبُوا  
بِآيَاتِنَا ۚ فَاقْصِصْ الْقِصَصَ لَعَلَّهُمْ  
يَتَفَكَّرُونَ ﴿٧٧﴾

سَاءَ مَثَلًا الْقَوْمِ الَّذِينَ كَذَبُوا بِآيَاتِنَا  
وَأَنْفُسَهُمْ كَانُوا يَظْلِمُونَ ﴿٧٨﴾

ai edhe ka besuar, për sa kohë që ashtu si ne, kërkon shkakun e pasojave. Edhe ky është një lloj pranimi, ndonëse jo i plotë. Përveç kësaj, një mohues të Zotit nëse me ndonjë metodë e bën pa ndjenja, në mënyrë që të shkëputet nga mendimet e ulëta dhe dëshirat tokësore dhe ai i gjithi të mbetet nën kontrollin e Qenies Supreme, ai do të pohojë përbrenda ekzistencën e Zotit dhe nuk do ta mohojë Atë, siç dëshmon përvoja e studiuesve të mëdhenj të kësaj fushe. Pikërisht për këtë gjendje flet ajeti i mësipërm dhe kuptimi i tij është se mohimi i ekzistencës së Zotit qëndron vetëm në gjendjen ku njeriu është i rrethuar me tundime, përndryshe ndërgjegjja e pastër është e mbushur me pohimin e Tij. Lexoni edhe 53:43.

39. Personi që përmendet në këtë ajet, komentuesit e quajnë Bal'em Ba'ur, të cilit Zoti i Madhërishtëm i kishte dhuruar dhunti shpirtërore që ai t'i afrohej Zotit, por për fatin e tij të keq, ai parapëlqeu të anonte nga bota. Shembulli i tij, thotë Kurani, është si i atij qeni që dihat edhe nëse dikush e sulmon, edhe kur nuk e sulmon. Edhe njeriu në fjalë, pasi devijoi nga rruga e drejtë, zuri të propagandonte gënjeshtërën.

179. Vetëm atë që e udhëzoi Allahu, është i udhëzuar, kurse atë që e cilëson të devijuar, është humbës.

مَنْ يَهْدِ اللَّهُ فَهُوَ الْمُهْتَدَىٰ ۖ وَمَنْ يُضِلِّ  
فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْخَاسِرُونَ ﴿٧٩﴾

180. Sigurisht, kemi krijuar për xhehenemin shumë xhindë dhe njerëz. Kanë zemra me të cilat nuk kuptojnë, kanë sy me të cilët nuk shohin, dhe kanë veshë me të cilët nuk dëgjojnë. Pikërisht këta janë si shtazë, madje më të devijuar. Pikërisht këta janë të pavëmendshmit.

وَلَقَدْ ذَرَأْنَا لِجَهَنَّمَ كَثِيرًا مِّنَ الْجِنِّ  
وَالإِنسِ ۗ لَهُمْ قُلُوبٌ لَا يَفْقَهُونَ بِهَا  
وَلَهُمْ أَعْيُنٌ لَا يُبْصِرُونَ بِهَا ۗ وَلَهُمْ أذَانٌ  
لَّا يَسْمَعُونَ بِهَا ۗ أُولَٰئِكَ كَالْأَنْعَامِ بَلْ  
هُمْ أَضَلُّ ۗ أُولَٰئِكَ هُمُ الْغَافِلُونَ ﴿٨٠﴾

181. Të Allahut janë emrat e bukur, ndaj, lutjuni Atij përmes tyre dhe lërinia ata që bëjnë shtrembërim në emrat e Tij. Atyre do t'ju jepet patjetër dënimi i asaj që bëjnë.

وَاللَّهُ الْأَسْمَاءِ الْحُسْنَىٰ فَادْعُوهُ بِهَا ۖ  
وَذَرُوا الَّذِينَ يُلَجِدُونَ فِي أَسْمَائِهِ  
سَيِّئُونَ مِمَّا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿٨١﴾

182. Nga ata që kemi krijuar, ka edhe njerëz që udhëzojnë me të vërtetën dhe po me anë të saj gjykojnë.

وَمِمَّنْ خَلَقْنَا أُمَّةٌ يَّهْدُونَ بِالْحَقِّ وَبِهِ  
يَعْدِلُونَ ﴿٨٢﴾

183. Ata që i quajtën gënjeshtër ajetet Tona, Ne do t'i zëmë shkallazi nga atje ku ata nuk dinë.

وَالَّذِينَ كَذَّبُوا بِآيَاتِنَا سَنَسْتَدْرِجُهُم مِّنْ  
حَيْثُ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٨٣﴾

184. U jap afat; strategjia Ime pa dyshim është shumë e fortë.

وَأَمْلِي لَهُمْ ۗ إِنَّ كَيْدِي مَتِينٌ ﴿٨٤﴾

185. A nuk kanë menduar se shoku i tyre nuk ka ndonjë çmenduri?! Ai është vetëm një alarmues i qartë.

أَوَلَمْ يَتَفَكَّرُوا ۗ مَا بِصَاحِبِهِمْ مِّنْ جِنَّةٍ ۗ  
إِن هُوَ إِلَّا نَذِيرٌ مُّبِينٌ ﴿٨٥﴾

186. A nuk thellohen në sundimin e qiejve e të tokës dhe në çdo gjë që Allahu ka krijuar dhe (në faktin) që mundet që afati i tyre është afuar?! E pas kësaj çfarë fjale tjetër do të

أَوَلَمْ يَنْظُرُوا فِي مَلَكُوتِ السَّمٰوٰتِ  
وَالْأَرْضِ وَمَا خَلَقَ اللَّهُ مِنْ شَيْءٍ ۗ  
وَأَنْ عَسَىٰ أَنْ يَكُونَ قَدِ اقْتَرَبَ أَجَلُهُمْ ۚ



besojnë ata?!<sup>40</sup>

187. Atë që Allahu e cilëson të devijuar, nuk ka udhëzues për të. Dhe Ai i lë ata të vërtiten në tërbimin e tyre.

188. Të pyesin rreth Orës se kur do të vijë ajo. Thuaju: Dija për të është vetëm te Zoti im. Askush nuk e shfaq atë në kohën e saj, përveç Atij. Ajo është e rëndë për qiejt dhe tokën. Ajo nuk do t'ju vijë përveçse papritmas. Të pyesin sikur ti je i informuar mirë për të. Thuaju: Dija për të është vetëm tek Allahu, por shumica e njerëzve nuk e dinë (këtë gjë).

189. Thuaju: Nuk zotëroj për veten time as ndonjë dobi e as dëm, përveç asaj që dëshiron Allahu. Dhe po ta dija të padukshmen, pa dyshim që mund të grumbulloja shumë të mira dhe as nuk do të më prekte vështirësia. Por jam vetëm një alarmues dhe sihariqdhënës për popullin që beson.

190. Është Ai që ju krijoi prej një qenie të vetme dhe prej saj bëri çiftin e saj që ai të gjejë qetësi tek ajo. E kur ai e mbuloi atë, ajo mbarti barrë të lehtë, pastaj filloi të lëvizte me të. E kur iu rëndua barra, ata të dy iu lutën Allahut, Zotit të tyre: “Nëse na jep një (djalë) të shëndetshëm, patjetër do të jemi falënderues!”

فَبِأَيِّ حَدِيثٍ بَعْدَهُ يُؤْمِنُونَ ﴿٨٧﴾

مَنْ يُضِلِلِ اللَّهُ فَلَا هَادِيَ لَهُ<sup>ط</sup> وَيَذَرُهُمْ فِي طُغْيَانِهِمْ يَعْمَهُونَ ﴿٨٧﴾

يَسْأَلُونَكَ عَنِ السَّاعَةِ أَيَّانَ مُرْسَاهَا قُلْ إِنَّمَا عِلْمُهَا عِنْدَ رَبِّي لَا يُجَلِّيهَا لِوَقْتِهَا إِلَّا هُوَ ثَقُلَتْ فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ لَا تَأْتِيكُمْ إِلَّا بَغْتَةً<sup>ط</sup> يَسْأَلُونَكَ كَأَنَّكَ حَفِيٌّ عَنْهَا قُلْ إِنَّمَا عِلْمُهَا عِنْدَ اللَّهِ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٨٨﴾

قُلْ لَا أَمْلِكُ لِنَفْسِي نَفْعًا وَلَا ضَرًّا إِلَّا مَا شَاءَ اللَّهُ<sup>ط</sup> وَلَوْ كُنْتَ أَعْلَمُ الْغَيْبِ لَا سْتَكْبَرْتُمْ مِنَ الْخَيْرِ<sup>٥</sup> وَمَا مَسْنِيَ السُّوءُ<sup>٥</sup> إِنْ أَنَا إِلَّا نَذِيرٌ<sup>٥</sup> وَبَشِيرٌ لِّقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ ﴿٨٩﴾

هُوَ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَجَعَلَ مِنْهَا زَوْجَهَا لِيَسْكُنَ إِلَيْهَا فَلَمَّا تَغَشَّهَا حَمَلَتْ حَمْلًا خَفِيًّا فَمَرَّتْ بِهِ<sup>٥</sup> فَلَمَّا أَثْقَلَتْ دَعَوَا اللَّهَ رَبَّهُمَا لَئِنْ آتَيْتَنَا صَالِحًا لَنُكَفِّرَنَّ مِنَ الشُّكْرِينَ ﴿٩٠﴾

40. Lexoni 45:7.

191. E kur Ai u dha një (djale) të shëndetshëm, ata zunë të krijonin ortakë (për Allahun) në atë çka u dha Ai. Allahu është shumë i lartë nga ato që ata i bëjnë ortakë (me Të).

192. A i bëjnë (Atij) ortakë që nuk krijojnë asgjë?! Ata vetë janë krijesa!

193. Ata nuk mund t'u japin asnjë ndihmë dhe as vetveten nuk e ndihmojnë dot.

194. E nëse i thërrisni drejt udhëzimit, nuk ju ndjekin. Si t'i thërrisni, si të jeni të heshtur, njësoj është për ta.

195. Sigurisht, ata që ju i lusni në vend të Allahut, janë robër si ju, andaj, (vijoni t'i) lusni. Ata duhet t'ju përgjigjen, në qoftë se jeni të vërtetë.

196. A kanë këmbë ata, me të cilat ecin?! A kanë duar, me të cilat mbajnë?! A kanë sy, me të cilët shohin?! A kanë veshë, me të cilët dëgjojnë?! Thuaju: Thirrini ortakët tuaj e më pas veproni kundër meje dhe mos më jepni afat!

197. Sigurisht, Kujdestari im është Allahu që zbriti Librin dhe Ai u bëhet Kujdestar të dëlirëve.

فَلَمَّا أَتَاهُمَا صَالِحًا جَعَلَا لَهُ شُرَكَاءَ فِيمَا  
أَتَاهُمَا فَتَعَالَى اللَّهُ عَمَّا يُشْرِكُونَ ﴿١٩١﴾

أَيُّشْرِكُونَ مَا لَا يَخْلُقُ شَيْئًا وَهُمْ  
يُخْلَقُونَ ﴿١٩٢﴾

وَلَا يَسْتَطِيعُونَ لَهُمْ نَصْرًا وَلَا أَنْفُسُهُمْ  
يَنْصُرُونَ ﴿١٩٣﴾

وَإِنْ تَدْعُوهُمْ إِلَى الْهُدَى لَا يَتَّبِعُوكُمْ  
سِوَاءَ عَلَيْكُمْ أَدْعَاؤُهُمْ أَمْ أَنْتُمْ  
صَامِتُونَ ﴿١٩٤﴾

إِنَّ الَّذِينَ تَدْعُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ عِبَادٌ  
أَمْثَلَكُمْ فَادْعُوهُمْ فَلْيَسْتَجِيبُوا لَكُمْ إِنْ  
كُنْتُمْ صَادِقِينَ ﴿١٩٥﴾

أَلَهُمْ أَرْجُلٌ يَمْشُونَ بِهَا ۗ أَمْ لَهُمْ أَيْدٍ  
يَبْطِشُونَ بِهَا ۗ أَمْ لَهُمْ أَعْيُنٌ يَبْصُرُونَ  
بِهَا ۗ أَمْ لَهُمْ آذَانٌ يَسْمَعُونَ بِهَا ۗ قُلْ  
ادْعُوا شُرَكَاءَكُمْ ثُمَّ كِيدُوا فَلَآ  
تَنْظُرُونَ ﴿١٩٦﴾

إِنَّ وَلِيََّ اللَّهُ الَّذِي نَزَّلَ الْكِتَابَ ۗ وَهُوَ  
يَتَوَلَّى الصَّالِحِينَ ﴿١٩٧﴾

198. Dhe ata që ju i lusni në vend të Tij, nuk mund t'ju ndihmojnë dhe as vetveten nuk e ndihmojnë dot.

وَالَّذِينَ تَدْعُونَ مِنْ دُونِهِ لَا يَسْتَطِيعُونَ  
نَصْرَكُمْ وَلَا أَنْفُسَهُمْ يَنْصُرُونَ ﴿١٩٨﴾

199. Nëse i thërrisni drejt udhëzimit, nuk dëgjojnë. Dhe ti do t'i shohësh që ata të shikojnë ty, kurse në të vërtetë nuk të shohin.

وَإِنْ تَدْعُوهُمْ إِلَى الْهُدَى لَا يَسْمَعُوا  
وَتَرَاهُمْ يَنْظُرُونَ إِلَيْكَ وَهُمْ لَا  
يُبْصِرُونَ ﴿١٩٩﴾

200. Përvetëso faljen, urdhëro për të mirën dhe shmangu nga të paditurit.

خُذِ الْعَفْوَ وَأْمُرْ بِالْعُرْفِ وَأَعْرِضْ عَنِ  
الْجَاهِلِينَ ﴿٢٠٠﴾

201. E nëse ty të vjen ndonjë pëshpëritje shqetësuese nga djalli, kërkoji mbrojtjen Allahut. Sigurisht, Ai është Gjithëdëgjues, i Gjithëdijshëm.

وَأَمَّا يَنْزِعَنَّكَ مِنَ الشَّيْطَانِ نَزْعٌ فَاسْتَعِذْ  
بِاللَّهِ إِنَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ ﴿٢٠١﴾

202. Ata që kanë drojë (ndaj Zotit), kur i prek ndonjë shqetësim i ardhur nga djalli, përkujtojnë shumë (Zotin), dhe papritmas dritësohen.

إِنَّ الَّذِينَ اتَّقَوْا إِذَا مَسَّهُمْ طَافٌ مِّنَ  
الشَّيْطَانِ تَذَكَّرُوا فَإِذَا هُمْ مُبْصِرُونَ ﴿٢٠٢﴾

203. Dhe vëllezërit (djallëzorë) të tyre (pra, të mohuesve) i tërheqin në humbje dhe më pas nuk kursejnë asgjë.

وَإِخْوَانُهُمْ يَمُدُّوهُمْ فِي الْغَيِّ ثُمَّ لَا  
يُقْصِرُونَ ﴿٢٠٣﴾

204. E kurdoherë që ti nuk u sjell ndonjë shenjë, thonë: "Pse nuk e ke zgjedhur atë?" Thuaju: Unë e ndjek vetëm atë që më është shpallur mua nga Zoti im. Këto janë dritësime nga Zoti juaj, udhëzim dhe mëshirë për njerëzit që besojnë.

وَإِذَا لَمْ تَأْتِهِمْ بَايَةٌ قَالُوا لَوْلَا اجْتَبَيْتَهَا  
قُلْ إِنَّمَا أَتَّبِعُ مَا يُوحَىٰ إِلَيَّ مِنْ  
رَبِّي ۚ هَذَا بَصَائِرٌ مِنْ رَبِّكُمْ وَهُدًى  
وَرَحْمَةً لِّقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ ﴿٢٠٤﴾

205. Kur lexohet Kurani, dëgjojeni atë dhe heshtni, që ju të mëshiroheni.

وَإِذَا قُرِئَ الْقُرْآنُ فَاسْتَمِعُوا لَهُ وَأَنْصِتُوا  
لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ ﴿٢٠٥﴾

206. Kujtoje Zotin tënd në zemrën tënde me përgjërim, me druajtje dhe jo me zë të lartë, mëngjeseve dhe mbrëmjeve, dhe mos u bëj ndër të pavëmendshmit.

وَإِذْ كُرِّرْنَا فِي نَفْسِكَ تَضَرُّعًا وَخِيفَةً  
وَدُونَ الْجَهْرِ مِنَ الْقَوْلِ بِالْغُدُوِّ وَالْآصَالِ  
وَلَا تَكُنْ مِنَ الْغَافِلِينَ ﴿٢٠٦﴾

207. Sigurisht, ata që janë pranë Zotit tënd, nuk mburren me adhurimin ndaj Tij, e përkujtojnë Atë dhe Atij i bëjnë sexhde.<sup>41</sup>

Sexhdeja I

إِنَّ الَّذِينَ عِنْدَ رَبِّكَ لَا يَسْتَكْبِرُونَ عَنْ  
عِبَادَتِهِ وَيُسَبِّحُونَهُ وَلَهُ يَسْجُدُونَ ﴿٢٠٧﴾

41. Te ky ajet vjen sexhdeja e parë e Kuranit. Ishte praktikë e Profetit<sup>savs</sup> që kudo që një ajet i Kuranit fliste për besimtarët që të bënin sexhde para Zotit, ai e bënte sexhden dhe, edhe sahabët e ndiqnin atë. Në hadithe përmendet që Profeti<sup>savs</sup> në sexhden e Kuranit, përveç përkujtimit të Zotit, bënte edhe disa lutje. Njëra prej tyre është kjo: “Fytyra ime po i bën sexhde Atij që e krijoi, i dhuroi veshët dhe sytë përmes mrekullisë dhe fuqisë së Tij.” (Tirmidhi, nr. 3425).

## Surja 8 – El-Enfal

Kjo sure u zbrit në Medinë. Bashkë me *bismil-lahin* ajo ka shtatëdhjetë e gjashtë ajete. Pasuria që të siguron Zoti për shkak të luftës, quhet “enfal”.

Në suren e mëparshme (në ajetin 188) përmendet kërkesa e mohuesve që t’u tregojnë se kur do të shfaqej Ora ose kiameti. Shfaqja e parë e Orës përmendet hollësisht në këtë sure dhe tregohet se arabëve tashmë u ka ardhur kjo orë, e cila do t’i jepte fund periudhës së mohimit dhe të idhujtarisë në vend.

Në fund të sures së mëparshme ishte paralajmëruar se do të vinin ditë shumë të vështira, andaj Profeti<sup>savs</sup> u porositi që, tani të përulej para Zotit dhe t’i lutej me ngashërim, me fshehtësi dhe me të qara, sepse vetëm në saje të lutjeve të tij, të gjitha vështirësitë do të kaloheshin.

Në fillim të kësaj sureje u dha lajmi i mirë që për shkak të këtyre vështirësive, besimtarët do ta kapërcenin skamjen materiale. Thuhet se njëra prej vështirësive do të ishte ajo e betejës së Bedrit dhe, në suren paraardhëse, ashtu siç i ishte bërë Profetit porosia për lutjet intensive, shohim që fitorja erdhi pikërisht për shkak të lutjeve të veçanta të Profetit Muhammed<sup>savs</sup>. Kështu që, 313 sahabë që morën pjesë në këtë betejë u përballën me një ushtri të idhujtarëve mekas, e cila, përveç aspektit shpirtëror, në çdo aspekt tjetër ishte shumë më e fuqishme sesa besimtarët. Mekasit kishin armët më të forta të kohës, kishin shigjetarët më të zotë, madje kishin edhe gra profesioniste që i ngërmonin e i nxitnin me këngë luftime. Megjithatë, muslimanët e fituan betejën për shkak të lutjeve të Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, të cilat ai i bëri me shumë përgjërime në çadrën e tij gjatë gjithë natës. Rrëfëhet që nga të qarat shpesh atij i binte çarçafi nga supet, dhe *Hazret Ebu Bekri*<sup>a</sup> ia rregullonte. Kulmi i këtyre lutjeve ishte që Profeti<sup>savs</sup> vazhdimisht thoshte i ngashëryer:

*“O Allah! Nëse shkatërrohet ky xhema i Islamit, nuk do të adhurohesh në tokë!”*  
(Sahih Muslim, kitab: “El-Xhihad ves-Sijer”, hadithi nr. 4588.)

Pra, Profeti<sup>savs</sup> me një fjalë thoshte: O Zot! Këta njerëz që unë i kam rritur vetëm për adhurimin Tënd, për synimin që është edhe qëllimi i krijimit të njerëzve e të xhindëve, nëse vriten, nuk do të ketë ndonjë xhema tjetër në tokë që të të adhurojë Ty. Andaj, merita e fitores në betejën e Bedrit është e lutjeve të Profetit Muhammed<sup>savs</sup>.

Gjithashtu, besimtarëve u është dhënë mësimi që pikërisht *takva* (droja ndaj Zotit) është arma kryesore, që do të bëjë dallimin e madh mes të vërtetëve dhe gënjeshtarëve dhe, edhe në të ardhmen, nëse ata synojnë triumfin mbi fuqitë e mëdha të botës, do të mund ta realizojnë vetëm nëse i përmbahen *takvasë*.

Në këtë sure është sqaruar edhe fakti se Profeti Muhammed<sup>savs</sup> dhe sahabët e tij kurrsesi nuk do të hynin në luftë, derisa nuk bëhej nga kundërshtarët tentativa me të njëjtin mjet për t’ua ndërruar fenë. Trazira më e madhe në botë lind dhe do të vijojë të lindë vetëm kur tentohet me forcë që njerëzit ta ndërrojnë fenë e tyre. Kurse

të shtypurit, në këtë rast, kanë të drejtën e mbrojtjes vetëm derisa të eliminohet kjo trazirë.

Në këtë sure është thënë se përkujtimi i Allahut është i nevojshëm për qëndrueshmërinë. Andaj, besimtarët që e zbatojnë këtë porosi edhe gjatë luftërave të frikshme, u jepet lajmi i mirë se pikërisht ata do të triumfojnë, pasi çdo triumf është i lidhur me përkujtimin e Zotit.

Në dy ajetet e fundit të kësaj sureje thuhet se nëse shtrëngimi nga ana e armikut e tejkalon çdo masë, dhe besimtarët detyrohen ta braktisin edhe vendin e tyre e të mërgojnë në një vend tjetër, ky mërgim do të pranohet te Zoti dhe se Ai do t'i ndihmojë besimtarët, duke i falur dhe duke u dhënë bereqet pa masë edhe në të mirat materiale. Kjo profeci gjithmonë është përmbushur me madhësi të plotë. Bereqeti i parë është ai që është përmendur në këtë sure me emrin e saj "Enfal" dhe i dyti do të ishte në formën e mundësive të reja që do t'u hapeshin besimtarëve muhaxhirë pas mërgimit.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Të pyesin për plaçkat e luftës. Thuaju: Plaçkat e luftës janë të Allahut dhe të të Dërguarit. Andaj, kini druajtje ndaj Allahut, përmirësoni marrëdhëniet tuaja të ndërsjella dhe bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij, në qoftë se jeni besimtarë.

يَسْأَلُونَكَ عَنِ الْأَنْفَالِ ۗ قُلِ الْأَنْفَالُ لِلَّهِ  
وَالرَّسُولِ ۗ فَاتَّقُوا اللَّهَ وَأَصْلِحُوا ذَاتَ  
بَيْنِكُمْ ۗ وَأَطِيعُوا اللَّهَ وَرَسُولَهُ إِن كُنْتُمْ  
مُؤْمِنِينَ ①

3. Besimtarët në të vërtetë janë ata, që kur u përmendet Allahu, u drithërohen zemrat e kur u lexohen ajetet e Tij, ato ua shtojnë besimin, dhe te Zoti i tyre ata mbështeten,

إِنَّمَا الْمُؤْمِنُونَ الَّذِينَ إِذَا ذُكِرَ اللَّهُ وَجِلَتْ  
قُلُوبُهُمْ وَإِذَا تُلِيَتْ عَلَيْهِمْ آيَاتُهُ زَادَتْهُمْ  
إِيمَانًا وَعَلَىٰ رَبِّهِمْ يَتَوَكَّلُونَ ②

4. që falin namazin dhe shpenzojnë nga ajo që Ne u kemi dhënë.

الَّذِينَ يُقِيمُونَ الصَّلَاةَ وَيَمَّا رَزَقْنَهُمْ  
يُنْفِقُونَ ③

5. Këta janë besimtarët e vërtetë. Ata kanë grada pranë Zotit të tyre, falje dhe dhuratë të nderuar.

أُولَٰئِكَ هُمُ الْمُؤْمِنُونَ حَقًّا لَهُمْ دَرَجَاتٌ  
عِنْدَ رَبِّهِمْ وَمَغْفِرَةٌ وَرِزْقٌ كَرِيمٌ ④

6. Ashtu siç Zoti yt të nxori nga shtëpia jote me vërtetësi, edhe pse një grup prej besimtarëve nuk e pëlqenin.

كَمَا أَخْرَجَكَ رَبُّكَ مِنْ بَيْتِكَ بِالْحَقِّ ۗ  
وَإِنَّ فَرِيضَةً مِنَ الْمُؤْمِنِينَ لَكَرِهُونَ ⑤

7. Polemizonin me ty rreth së vërtetës, pasi ajo u ishte bërë e qartë, sikur po shtyheshin drejt vdekjes që po e shihnin (me sy).

يَجَادِلُونَكَ فِي الْحَقِّ بَعْدَ مَا تَبَيَّنَ كَأَنَّمَا  
يَسَاقُونَ إِلَى الْمَوْتِ وَهُمْ يَنْظُرُونَ ⑥

8. Dhe (kujtoni) kur Allahu ju premtoi njërin prej dy grupeve që ai do të ishte për ju, dhe ju dëshironit të kishit pjesën që nuk ju vështirësonte ju. Kurse Allahu dëshironte ta vërtetonte të vërtetën përmes fjalëve të Tij e ta priste rrënjën e mohuesve.<sup>1</sup>

9. Që ta vërtetonte të vërtetën e ta përgënjeshtronte të rremen, edhe nëse keqbërësit do ta urrenin këtë.

10. Kur ju i luteshit për ndihmë Zotit tuaj dhe Ai jua pranoi (lutjen me premtimin): Unë sigurisht do t'ju përforcoj me një mijë engjëj të rreshtuar.

11. Dhe këtë Allahu e bëri vetëm si sihariq dhe që t'ju qetësoheshin zemrat me anë të tij. Nuk ka ndihmë, përveçse prej Allahut. Sigurisht, Allahu është i Plotfuqishëm, i Urtë.

12. Kur Ai po ju mbulonte me dremitjen si paqe prej Vetes dhe ju zbriste ujë prej qiellit, që t'ju pastronte përmes tij, të largonte prej jush ndyrësinë e djallit, t'jua lidhte zemrat dhe t'jua forconte këmbët përmes tij.<sup>2</sup>

وَإِذْ يَعِدُّكُمْ اللَّهُ إِحْدَى الطَّائِفَتَيْنِ أَنَّهَا لَكُمْ وَتَوَدُّونَ أَنَّ غَيْرَ ذَاتِ الشَّوْكَةِ تَكُونُ لَكُمْ وَيُرِيدُ اللَّهُ أَنْ يُحَقِّقَ الْحَقَّ بِكَلِمَاتِهِ وَيَقْطَعَ دَابِرَ الْكَافِرِينَ ۝

لِيُحَقِّقَ الْحَقَّ وَيُطْلَلَ الْبَاطِلَ وَلَوْ كَرِهَ الْمُجْرِمُونَ ۝

إِذْ تَسْتَعِينُونَ رَبِّكُمْ فَأَسْتَجَابَ لَكُمْ أَنِّي مُمِدُّكُمْ بِأَلْفٍ مِنَ الْمَلَائِكَةِ مُرَدِّفِينَ ۝

وَمَا جَعَلَهُ اللَّهُ إِلَّا بُشْرَىٰ وَلِتَضْمِنَ لَهُ قُلُوبُكُمْ ۗ وَمَا النَّصْرُ إِلَّا مِنْ عِنْدِ اللَّهِ ۗ إِنَّ اللَّهَ عَزِيزٌ حَكِيمٌ ۝

إِذْ يُغَشِّيكُمُ التُّعَاسَ أَمَنَةً مِنْهُ وَيُنزِلُ عَلَيْكُمْ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً لِيُطَهِّرَكُم بِهِ وَيُذْهِبَ عَنْكُمْ رِجْزَ الشَّيْطَانِ وَلِيَرْبِطَ عَلَى قُلُوبِكُمْ وَيُثَبِّتَ بِهِ الْأَقْدَامَ ۝

1. Bëhet fjalë për betejën e parë të muslimanëve, që quhet Beteja e Bedrit e që ndodhi rreth 13 muaj pas Hixhretit. “Dy grupet” nënkuptojnë: (1) ushtrinë mekase, plotësisht të armatosur dhe që kishte ardhur e përgatitur për të mbrojtur karvanin e tyre tregtar, dhe (2) karvanin mekas që kthehej nga veriu për të shkuar në Mekë dhe që ishte i armatosur lehtë. Muslimanët natyrshëm donin të ndesheshin me karvanin, por qëllimi i Zotit ishte të përballeshin me ushtrinë, në mënyrë që, siç pohojnë fjalët e këtij ajeti, Allahu ta zbulonte të Vërtetën me fjalët e Tij dhe t’ua priste rrënjët mohuesve mekas. Lexoni edhe 3:14 dhe 8:42-45.

2. Në këtë betejë, muslimanët ishin zbarkuar në ranishte, kurse ushtria mekase në tokë të fortë. Shiu në kohë e bëri vendin e parë të fortë dhe të dytin të rrëshqitshëm.



13. Kur Zoti yt u shpallte engjëjve: Unë gjithsesi jam me ju, andaj, jepuni forcë atyre që besuan. Unë patjetër do të vë frikë në zemrat e atyre që mohuan. Ndaj, bjeruni mbi qafat dhe goditini në çdo nyje të tyre.

14. Kjo sepse ata e kundërshtuan ashpër Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe ai që kundërshton ashpër Allahun dhe të Dërguarin e Tij, (ta dijë se) Allahu është i ashpër në ndëshkim.

15. Kjo është (ajo që keni korrur), andaj, shijojeni, dhe (dijeni) që për mohuesit me siguri është ndëshkimi i zjarrit.

16. O ju që besuat! Kur të ndesheni me ushtri të atyre që mohuan, mos ua ktheni shpinën.

17. Ai që ua kthen atë ditë shpinën, jo si lëvizje lufte ose si përpjekje për t'u bashkuar me një njësi (të vet), do të kthehet me zemërimin e Allahut, dhe vendi i tij do të jetë xhehenemi. Sa destinacion i keq është ai!

18. Pra, ju nuk i vratë, por Allahu i vrau ata dhe (o Muhammed!), kur ti gjuajte gurë (në drejtim të tyre), nuk i gjuajte ti, por i gjuajti Allahu. Kjo ndodhi që Ai t'i vinte besimtarët në një sprovë të mirë. Sigurisht, Allahu është Gjithëdëgjues, i Gjithëdijshëm.<sup>3</sup>

إِذْ يُوحَىٰ رَبُّكَ إِلَى الْمَلَائِكَةِ أَنِّي مَعَكُمْ  
فَثَبَّتُوا الَّذِينَ آمَنُوا سَائِقِينَ فِي قُلُوبِ  
الَّذِينَ كَفَرُوا الرَّعْبَ فَاصْرَبُوا فَوْقَ  
الْأَعْنَاقِ وَاصْرَبُوا مِنْهُمْ كُلَّ بَنَانٍ ١٣

ذَلِكَ بِأَنَّهُمْ شَاقُّوا اللَّهَ وَرَسُولَهُ ۚ وَمَنْ  
يُشَاقِقِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ فَإِنَّ اللَّهَ شَدِيدُ  
الْعِقَابِ ١٤

ذِكْرُكُمْ فَذُوقُوهُ وَأَنَّ لِلْكَافِرِينَ عَذَابَ  
التَّارِ ١٥

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا لَقِيتُمْ الَّذِينَ  
كَفَرُوا زَحَفًا فَلَا تُوَلُّوهُمْ الْأَدْبَارَ ١٦

وَمَنْ يُؤَلِّهِمْ يَوْمَئِذٍ دُبْرَهُ إِلَّا مَتَحَرِّفًا  
لِّقِتَالٍ أَوْ مَتَحَرِّزًا إِلَىٰ فِئَةٍ فَقَدْ بَاءَ  
بِغَضِبِ مِنَ اللَّهِ وَمَا لَهُ جَهَنَّمُ ۖ وَيَسَّ  
الْمَصِيرُ ١٧

فَلَمْ تَقْتُلُوهُمْ وَلَكِنَّ اللَّهَ قَتَلَهُمْ ۖ وَمَا  
رَمَيْتَ إِذْ رَمَيْتَ وَلَكِنَّ اللَّهَ رَمَىٰ ۚ  
وَلِيُبْلِيَ الْمُؤْمِنِينَ مِنْهُ بَلَاءً حَسَنًا ۗ  
إِنَّ اللَّهَ سَمِيعٌ عَلِيمٌ ١٨

3. Ky ajet flet për fitoren madhështore të betejës së Bedrit, e cila në dukje u realizua nga forcat e sahabëve, por kur ata i vrisnin mohuesit, i vrisnin për shkak të një caktimi prej Zotit. Një

19. Kështu ishit ju. Dhe sigurisht, Allahu e dobëson strategjinë e mohuesve.

20. (Ndaj, o besimtarë!) Nëse kërkuat fitoren, ja ku ju erdhi fitorja. Dhe (o mohues!) Nëse hiqni dorë, do të jetë mirë për ju, dhe nëse e përsërisni, edhe Ne do ta përsërisim. Grumbulli juaj sado i madh qoftë, kurrsesi nuk do t'ju vlejë. Sigurisht, Allahu është me besimtarët.

21. O ju që besuat! Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe kur e dëgjoni atë, mos ia ktheni shpinën.

22. Mos u bëni si ata që thanë: “Ne dëgjuam”, por ata nuk dëgjonin.

23. Gjallesat më të këqija tek Allahu janë ata që janë të shurdhër, memecë që nuk kuptojnë.

24. Nëse Allahu di ndonjë të mirë te ta, do t'i bënte të dëgjonin. Edhe sikur t'i bënte të dëgjonin, ata shmangen duke e kthyer shpinën.

25. O ju që besuat! Përgjigjuni Allahut dhe të Dërguarit kur ai ju thërret që t'ju ringjallë.<sup>4</sup> Dijeni se

ذِكْمٌ وَأَنَّ اللَّهَ مُوْهِنٌ كَيْدَ الْكٰفِرِيْنَ ﴿١٩﴾

إِنْ تَسْتَفْتِحُوْا فَقَدْ جَاءَكُمْ الْفَتْحُ ۚ وَإِنْ تَنْتَهُوْا فَهُوَ خَيْرٌ لَّكُمْ ۚ وَإِنْ تَعُوْذُوا لَعُدَّ ۚ وَكَانَ تَعْنَىٰ عَنْكُمْ فِتْنَتَكُمْ شَيْئًا ۚ وَ لَوْ كَثُرَتْ ۗ وَأَنَّ اللَّهَ مَعَ الْمُؤْمِنِيْنَ ﴿٢٠﴾

يٰۤاَيُّهَا الَّذِيْنَ اٰمَنُوْا اطِيعُوْا اللَّهَ وَرَسُوْلَهُ وَلَا تَوَلَّوْا عَمَّهٖ وَاَنْتُمْ تَسْمَعُوْنَ ﴿٢١﴾

وَلَا تَكُوْنُوْا كَالَّذِيْنَ قَالُوْا سَمِعْنَا وَهُمْ لَا يَسْمَعُوْنَ ﴿٢٢﴾

إِنَّ شَرَّ الدَّوَابِّ عِنْدَ اللَّهِ الضَّمٰمُ الَّتِيْكُمْ الَّلَّذِيْنَ لَا يَعْقِلُوْنَ ﴿٢٣﴾

وَلَوْ عَلِمَ اللَّهُ فِيْهِمْ خَيْرًا لَّأَسْمَعَهُمْ ۗ وَلَا سَمِعَهُمْ لَتَوَلَّوْا وَهُمْ مُّعْرِضُوْنَ ﴿٢٤﴾

يٰۤاَيُّهَا الَّذِيْنَ اٰمَنُوْا اسْتَجِيْبُوْا لِلّٰهِ وَرَسُوْلٍ اِذَا دَعَاكُمْ لِمَا يُحْيِيْكُمْ ۚ وَاعْلَمُوْا اَنَّ

shenjë e dukshme e këtij caktimi u shfaq atëherë kur Profeti Muhammed<sup>savs</sup> gjuajti gurë në drejtim të mohuesve dhe, në mbështetje të veprimit të tij, filloi një furtunë e fuqishme drejt tyre. Kjo bëri që mohuesit thuajse të mos shikonin asgjë dhe për ushtrinë e muslimanëve ishte e lehtë t'i mundte. Po në këtë formë erdhi edhe ndihma e engjëjve që u përmend pak më sipër.

4. Folja *thërret* lidhet me emrin e fundit, i cili është i Dërguari. Pra, i Dërguari ju thërret për t'ju ringjallur, dhe përgjigjja ndaj thirrjes së tij është e barabartë me përgjigjen ndaj thirrjes së Allahut dhe të Dërguarit (Buhari, nr. 4647). Ky ajet pohon se Profeti Muhammed<sup>savs</sup> ringjallte

Allahu qëndron mes njeriut dhe zemrës së tij dhe se tek Ai do të tuboheni.<sup>5</sup>

اللَّهُ يَحُولُ بَيْنَ الْمَرْءِ وَقَلْبِهِ وَأَنَّهُ إِلَيْهِ  
مُخْتَصِرُونَ ﴿٥﴾

26. Druhuni nga sprova që i zë jo vetëm ata që bënë padrejtësi mes jush, dhe dijeni se Allahu përnjëmend është shumë i rreptë në ndëshkim.

وَاتَّقُوا فِتْنَةً لَا تُصِيبَنَّ الَّذِينَ ظَلَمُوا  
مِنْكُمْ خَاصَّةً ۗ وَاعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ شَدِيدُ  
الْعِقَابِ ﴿٦﴾

27. Dhe kujtojeni kur ishit pak, llogaritësit të dobët në tokë, frikësoheshit se mos ju rrëmbenin njerëzit, atëherë Ai ju strehoi, ju përkrahu me ndihmën e Tij dhe ju ushqeu me të pastrat, që ju të falënderoni.

وَاذْكُرُوا إِذْ أَنْتُمْ قَلِيلٌ مُسْتَضْعَفُونَ فِي  
الْأَرْضِ تَخَافُونَ أَنْ يَتَخَفَّكُمْ النَّاسُ  
فَأُولَئِكَ مَأْوَىٰكُمْ ۗ وَإِذْ لَكُمْ بِبَصْرِهِمْ  
وَرَزَقِكُمْ ۖ مِمَّنْ  
الطَّيِّبَاتِ لَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ ﴿٧﴾

28. O ju që besuat! Mos tradhtoni Allahun dhe të Dërguarin, sepse si rrjedhë do të tradhtoni amanetet tuaja me vetëdije.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَخُونُوا اللَّهَ  
وَالرَّسُولَ وَتَخُونُوا أَمْنِيَكُمْ وَأَنْتُمْ  
تَعْلَمُونَ ﴿٨﴾

të vdekurit, dhe të gjithë dijetarët muslimanë e dinë se ai ringjalli njerëzit që shpirtërisht ishin të vdekur, e jo të vdekurit fizikë. Kështu që, ringjallja e të vdekurve kur i atribuohet një Profeti të Zotit, duhet të merret në kuptimin e saj metaforik a shpirtëror. I njëjti është kuptimi edhe i ringjalljes së të vdekurve nga ana e Hazret Isait<sup>as</sup>. Çfarë e shkaktoi atë që ndodhi në shkretëtirën e Arabisë; kur brenda pak ditësh erdhën në jetë qindra mijëra “të vdekur”, të kequdhëhequrit prej brezash, morën ngjyra Hyjnore; “të verbrit” fituan shikimin; “memecët” filluan të flasin për njohjen e Zotit dhe bota përnjëherë pati një revolucion të tillë, që nuk ishte parë a dëgjuar më parë? Ishin përgjërimit gjatë netëve të errëta të Profetit<sup>savs</sup> që ishte përhumbur pas Allahut, dhe që lëshuan një britmë në të gjithë botën dhe shfaqën mrekulli të tilla, saqë dukeshin të pamundura për një të paarsimuar e të papërkrahur si ai. Lexoni edhe 3:50.

5. Fjalët “Allahu qëndron mes njeriut dhe zemrës së tij” nënkuptojnë se njeriu (ose egoja e tij) nuk ka kontroll mbi zemrën e tij, kështu që ai nuk mund ta bëjë atë t’u bindet diktateve të tij. Fjalët mund të nënkuptojnë gjithashtu se njeriu duhet të nxitojë të dëgjojë dhe t’i përgjigjet thirrjes Hyjnore, sepse nëse dikush vonon ta bëjë këtë, rrethana të paparashikuara mund të ndërhyjnë për t’i bërë zemrën të ngurtë e të ndryshkur dhe më pas ai mund të refuzojë ta dëgjojë të vërtetën. Ndër atributet e Allahut janë që Ai është afër, Ai është larg, në të njëjtën mënyrë po prej attributeve të Tij është që Ai qëndron midis njeriut dhe zemrës së tij.

29. Dhe dijëni se pasuritë tuaja dhe fëmijët tuaj janë një sprovë dhe se tek Allahu ka shpërblim madhor.

وَأَعْلَمُوا أَنَّمَا آمَوَّالُكُمْ وَأَوْلَادُكُمْ  
فِتْنَةٌ ۗ وَأَنَّ اللَّهَ عِنْدَهُ أَجْرٌ عَظِيمٌ ﴿١١﴾

30. O ju që besuat! Nëse keni drujtje ndaj Allahut, Ai do t'ju përgatisë një (shenjë) dalluese, do t'ju fshijë mëkatet tuaja dhe do t'ju falë. Allahu ka bekim të madh!<sup>6</sup>

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِن تَتَّقُوا اللَّهَ يَجْعَلْ  
لَكُمْ فُرْقَانًا ۖ وَيُكَفِّرْ عَنْكُمْ سَيِّئَاتِكُمْ  
وَيَغْفِرْ لَكُمْ ۗ وَاللَّهُ ذُو الْفَضْلِ الْعَظِيمِ ﴿١٢﴾

31. Dhe (kujtoje) kur mohuesit bënë strategji kundër teje, që të të internonin, ose të të vrisnin, ose të të dëbonin ty; edhe ata bënë strategji, edhe Allahu bënte strategji. Allahu është strategu më i mirë.<sup>7</sup>

وَإِذْ يَمْكُرُ بِكَ الَّذِينَ كَفَرُوا لِيُثْبِتُوكَ  
أَوْ يَقْتُلُوكَ أَوْ يُخْرِجُوكَ ۗ وَيَمْكُرُونَ  
وَيَمْكُرُ اللَّهُ ۗ وَاللَّهُ خَيْرُ الْمَكْرِينِ ﴿١٣﴾

32. Dhe kur atyre u lexohen ajetet Tona, thonë: “I kemi dëgjuar; po të duam, mund të themi edhe ne si këto; këto janë thjesht përrallat e të parëve”.

وَإِذَا تُلِيَتْ عَلَيْهِمْ آيَاتُنَا قَالُوا قَدْ سَمِعْنَا  
لَوْ نَشَاءُ لَقُلْنَا مِثْلَ هَذَا ۗ إِنْ هَذَا إِلَّا  
أَسَاطِيرُ الْأَوَّلِينَ ﴿١٤﴾

6. Çfarë është kjo shenjë dalluese që u premtohet besimtarëve të cilët ushqejnë drujtje ndaj Allahut? Ajo është një dritë që nuk do ta kenë të tjerët, pra drita e komunikimit me Zotin qoftë përmes shpalljes, qoftë përmes pranimit të shpeshtë të lutjeve, qoftë përmes mrekullisë së pastrimit shpirtëror. Mrekullia më e madhe që u jepet njerëzve të Zotit për shkak të drujtjes së tyre ndaj Tij, është pikërisht drita që pasqyrohet nga zemra dhe nga mendja dhe nga të gjitha aftësitë e tyre; përmes kontaktit me Zotin, ata fuqizohen dhe pastrohen në atë mënyrë, që të tjerët nuk mund të gëzojnë një gjë të tillë. Kështu që, aftësitë dhe shqisat e tyre shpirtërore bëhen tejet të mprehta dhe urtësia Hyjnore fillon të rrjedhë në gjithë shpirtin e tyre.

7. Luftërat në historinë e Profetit dhe të sahabëve të tij nuk ishin të atilla siç lufton një mbret i fuqishëm kundër një populli të dobët me qëllim që ta pushtojë atë. Përkundrazi, për një kohë të gjatë kundërshtarët i persekutuan të Dërguarin e Allahut dhe ndjekësit e tij, shumë prej tyre edhe i vranë në mënyrë barbare, madje thurën komplete të mirëfillta për ta vranë edhe Profetin tonë të dashur, dhe të gjitha këto “arritje” ata ua atribuonin idhujve të tyre, duke proklamuar se ata ishin zota të vërtetë. Më pas, i Dërguari i Allahut u detyrua ta linte fshehurazi vendlindjen, dhe edhe gjatë mërgimit, kundërshtarët nuk e lanë të qetë. Pastaj, ata shkuan deri në tokën e huaj për t'i sulmuar muslimanët. Atëherë, për ta ndaluar sulmin e tyre, për të liruar ata muslimanë që ishin në pranga në Mekë, për të fituar lirinë e besimit dhe për të treguar se nuk ishin idhujt që u jepnin forcë dhe fitore idhujtarëve kundër besimtarëve, Zoti i Madhërishëm i lejoi muslimanët të luftonin kundër tyre. Ajeti në fund thotë se Allahu është *strategu më i mirë* (arab. *khajrul-mākirin*), që do të thotë se strategjia e Allahut ka vetëm mbarësi dhe se ajo nuk ka asnjë ligësi.

33. Dhe kur thoshin: “O Allah! Nëse kjo pikërisht është e vërteta prej Teje, lëshona mbi ne rrebesh gurësh prej qiellit, ose sillna ndonjë ndëshkim të dhimbshëm!”

وَإِذْ قَالُوا اللَّهُمَّ إِنْ كَانَ هَذَا هُوَ الْحَقُّ  
مِنْ عِنْدِكَ فَأَمْطِرْ عَلَيْنَا حِجَارَةً مِّنَ  
السَّمَاءِ أَوْ آتِنَا بِعَذَابٍ آلِيمٍ ﴿٣٣﴾

34. Allahu nuk i ndëshkon ata kur ti je mes tyre. Dhe Allahu nuk i ndëshkon ata kur ata kërkojnë falje.

وَمَا كَانَ اللَّهُ لِيُعَذِّبَهُمْ وَأَنْتَ فِيهِمْ  
ط  
وَمَا كَانَ اللَّهُ مُعَذِّبَهُمْ وَهُمْ  
يَسْتَغْفِرُونَ ﴿٣٤﴾

35. E çfarë kanë ata që Allahu të mos i ndëshkojë, ndërkohë që ata pengojnë (njerëzit) për në Xhaminë e shenjtë, edhe pse ata nuk janë kujdestarë të saj. Kujdestarët e saj janë vetëm të druajturit (ndaj Zotit), por shumica e tyre nuk e dinë.<sup>8</sup>

وَمَا لَهُمْ آلَا يُعَذِّبُهُمُ اللَّهُ وَهُمْ يَصُدُّونَ  
عَنِ الْمَسْجِدِ الْحَرَامِ وَمَا كَانُوا أَوْلِيَاءَهُ  
ط  
إِنْ أَوْلِيَاؤُهُ إِلَّا الْمُتَّقُونَ وَلَكِنْ أَكْثَرُهُمْ  
لَا يَعْلَمُونَ ﴿٣٥﴾

36. Adhurimi i tyre pranë shtëpisë (së Allahut) është vetëm fishkëllima dhe duartrokitje. “Ndaj, shijoni ndëshkimin për shkak se mohoni!”

وَمَا كَانَ صَلَاتُهُمْ عِنْدَ الْبَيْتِ إِلَّا مُكَاءً  
وَتَصَدِيَةً ٥ فَذُوقُوا الْعَذَابَ بِمَا كُنْتُمْ  
تَكْفُرُونَ ﴿٣٦﴾

37. Sigurisht, ata që mohuan, shpenzojnë paratë e tyre për të penguar nga rruga e Allahut. Ata do të vijojnë të shpenzojnë (në këtë mënyrë), më pas ato (para) do t’u bëhen dëshpëruese e më pas ata do të munden. Ata që mohuan do të tubohen për në xhehenem.

إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا يُنْفِقُونَ أَمْوَالَهُمْ  
لِيَصُدُّوا عَنِ سَبِيلِ اللَّهِ ٥ فَسَيُنْفِقُونَهَا ثُمَّ  
تَكُونُ عَلَيْهِمْ حَسْرَةً ثُمَّ يُغْلَبُونَ ٥ وَالَّذِينَ  
كَفَرُوا إِلَىٰ جَهَنَّمَ يُحْشَرُونَ ﴿٣٧﴾

38. Që Allahu ta ndajë të ndytin nga i pastërti, ta mbivendosë të ndytin pjesë-pjesë, ta bëjë piring të gjithin

لِيَمِيزَ اللَّهُ الْخَبِيثَ مِنَ الطَّيِّبِ وَيَجْعَلَ  
الْخَبِيثَ بَعْضَهُ عَلَىٰ بَعْضٍ فَيَرْكُمَهُ

8. Kujdestaria e Xhamisë së shenjtë që kishin idhujtarët, ishte thjesht në aspektin lëndor të Xhamisë. Kujdestaria e saj e vërtetë gjithmonë ka qenë në përgjegjësinë e besimtarëve, edhe në të kaluarën, edhe në të ardhmen.

dhe ta flakë në xhehenem. Këta janë humbësit.

39. Thuaju atyre që mohuan se nëse heqin dorë, do t'u falet çdo gjë që ka kaluar. E nëse përsërisin, atëherë t'i kenë parasysh historitë e të parëve.

40. Dhe luftoni me ta derisa të mos mbetet ndonjë trazirë dhe feja e gjitha të bëhet e Allahut. Nëse ata heqin dorë, sigurisht Allahu është Gjithëshikuesi i asaj që ata bëjnë.<sup>9</sup>

41. E nëse e kthejnë shpinën, dijeni se Allahu është Kujdestari juaj. Sa Kujdestar i mirë dhe sa Ndhmës i mirë është Ai!

Xhuzi 10

42. Dhe dijeni se çdo gjë që do të gjeni si plaçkë lufte, një e pesta e saj është e Allahut, e të Dërguarit, e të afërmve, e jetimëve, e nevojtarëve dhe e udhëtarëve, nëse besoni Allahun dhe atë që kemi zbritur mbi robin Tonë ditën e dallimit, ditën kur u ndeshën të dyja grupet.<sup>10</sup> Allahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë.

43. (Kujtojeni) kur ju ishit në skajin këtej, kurse ata në skajin andej, kurse

9. Ky ajet përbën një argument të fort kundër dënimit të apostazisë. Fjala "fitne" (trazirë) në këtë ajet do të thotë t'i ndërrosh dikujt fenë me forcë. Kështu që, derisa feja nuk bëhet tërësisht e lirë dhe të jetë vetëm e Allahut, lejohet që të shtypurit po me mjetet e kundërshtarëve, të bëjnë xhihad me kundërshtarët. Zoti i porositi muslimanët të luftonin derisa të mos kishte më persekutim fetar dhe njerëzit të ishin të lirë të praktikonin fenë që donin, pra, çështja e fesë të kthehej tërësisht në Dorën e Allahut. Lexoni edhe 2:194.

10. Ditën e Betejës së Bedrit. Lexoni 8:8.

جَمِيعًا فَيَجْعَلُهُ فِي جَهَنَّمَ ۗ أُولَٰئِكَ هُمُ  
عُ الْخٰسِرُونَ ﴿٣٩﴾

قُلْ لِلَّذِينَ كَفَرُوا إِنْ يَنْتَهُوا يُغْفَرْ لَهُمْ  
مَا قَدْ سَلَفَ ۗ وَإِنْ يَعُودُوا فَقَدْ مَضَتْ  
سُنَّتُ الْأَوَّلِينَ ﴿٤٠﴾

وَقَاتِلُوهُمْ حَتَّى لَا تَكُونَ فِتْنَةٌ وَيَكُونَ  
الدِّينُ كُلُّهُ لِلَّهِ ۚ فَإِنِ انْتَهَوْا فَإِنَّ اللَّهَ بِمَا  
يَعْمَلُونَ بَصِيرٌ ﴿٤١﴾

وَإِن تَوَلَّوْا فَأَعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ مَوْلَكُمْ ۗ  
نِعْمَ الْمَوْلَىٰ وَنِعْمَ النَّصِيرُ ﴿٤٢﴾

يٰۤأَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِنَّا جَعَلْنَا لَكُمُ  
اللَّهِ حُكْمًا وَاللِّرْسُولَٰ وَمَا آتَيْنَاكَ  
وَأَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِنَّا جَعَلْنَا لَكُمُ  
اللَّهِ حُكْمًا وَاللِّرْسُولَٰ وَمَا آتَيْنَاكَ  
يَوْمَ الْفُرْقَانِ يَوْمَ التَّقَىٰ الْجَمْعِ ۗ وَاللَّهُ  
عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿٤٣﴾

إِذْ أَنْتُمْ بِأَعْدَاةِ الدُّنْيَا وَهُمْ بِأَعْدَاةِ  
الْقُصُوفِ وَالرَّكْبِ اسْفَلَ مِنْكُمْ ۗ وَلَوْ

poshtë ju të dyve gjendej karvani. Edhe sikur t'i premtonit njëri-tjetrit (për t'u ndeshur me ndonjërin prej grupeve), do të gabonit patjetër në caktim. Por (ndodhi ndryshe), që Allahu të kryente një çështje, e cila ishte e vendosur: në bazë të provës së qartë, të shkatërrohej ai që ishte për t'u shkatërruar, dhe (po) në bazë të provës së qartë, të jetonte ai që ishte për të jetuar. Sigurisht, Allahu është Gjithëdhëgues, i Gjithëdhijshëm.

44. (Kujtoje) kur Allahu në gjumin tënd ty t'i tregonte ata të paktë. E po t'i tregonte ty të shumtë, atëherë (o besimtarë!) me siguri do të humbnit kurajën dhe do të kundërshtonit në këtë çështje, por Allahu (ju) shpëtoi. Sigurisht, Ai është i Gjithëdhijshëm për gjithçka që mbajnë kraharorët.

45. (Kujtojeni) kur jeni ndeshur, Ai jua tregonte ata të paktë në sytë tuaj, kurse ju akoma më të paktë në sytë e tyre, që Allahu të kryente një çështje që ishte vendosur. Tek Allahu kthehen çështjet.<sup>11</sup>

تَوَاعَدْتُمْ لِاخْتِلَافِ فِي الْمِعَادِ وَلَكِنْ لِيَقْضِيَ اللَّهُ أَمْرًا كَانَ مَفْعُولًا لِيَهْلِكَ مَنْ هَلَكَ عَنِ بَيْنَةِ وَيَحْيَى مَنْ حَيَّ عَنْ بَيْنَةٍ وَإِنَّ اللَّهَ لَسَمِيعٌ عَلِيمٌ ﴿٤٤﴾

إِذْ يُرِيكَهُمُ اللَّهُ فِي مَنَامِكَ قَلِيلًا ۖ وَلَوْ أَرَاكَهُمْ كَثِيرًا لَفَشَلْتُمْ وَتَنَازَعْتُمْ فِي الْأَمْرِ وَلَكِنَّ اللَّهَ سَلَّمَ ۗ إِنَّهُ عَلِيمٌ بِذَاتِ الصُّدُورِ ﴿٤٤﴾

وَإِذْ يُرِيكُمْوَهُمْ إِذِ التَّقَيْتُمْ فِي أَعْيُنِكُمْ قَلِيلًا وَيُقَلِّلُكُمْ فِي أَعْيُنِهِمْ لِيَقْضِيَ اللَّهُ أَمْرًا كَانَ مَفْعُولًا ۗ وَإِلَى اللَّهِ تُرْجَعُ الْأُمُورُ ﴿٤٥﴾

11. Ajetet 43 – 45: Muslimanët nuk kishin ndërmend të bënin luftë përpara se të ndodhte beteja e Bedrit, madje ata kishin marrë lajmin e një karvani tregtar të mekasve, të cilin për ta bllokuar ata ishin nisur nga Medina, pasi mekasit do ta përdornin pasurinë e tij për të luftuar kundër muslimanëve. Por ata u ndeshën me një ushtri që po vinte nga Meka në mbrojtje të karvanit. Ishte një caktim i veçantë i Zotit të Madhërishtëm që muslimanët pavarësisht se ishin shumë pak në numër, patën guximin të përballëshin me një numër shumë më të madh sesa ata vetë. Përndryshe, ata që ishin të dobët prej muslimanëve, mbase nuk do të dilnin nga shtëpia për këtë përballje. Fjalët “që të shkatërrohej përmes shenjës së qartë ai që ishte për t'u shkatërruar”: këtu thuhet se ata që zotërojnë argument të qartë, së cilës në arabisht i thonë “bejjneh”, patjetër ngadhënjëjnë, kurse ata që nuk e zotërojnë këtë, përfundimisht shkatërrohen.

46. O ju që besuat! Kur të ndesheni me ndonjë çetë, jini të palëkundur dhe përkujtojeni shumë Allahun, që të keni sukses.

47. Dhe bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe mos u grindni me njëri-tjetrin, përndryshe do të humbni kurajën dhe do t'ju ikë fuqia. Duroni. Sigurisht, Allahu është me të duruarit!

48. Mos u bëni si ata që dolën nga shtëpitë e tyre për t'u mburrur dhe sa për sy e faqe të njerëzve dhe (që) pengojnë nga rruga e Allahut. Allahu i ka vënë rreth punës që bëjnë.

49. (Kujtojeni) kur djalli ua zbukuroi punët atyre dhe u tha: “Nga njerëzit sot askush nuk mund t'ju mundë dhe unë jam streha juaj”. E kur u ballafaquan të dyja grupet, ai u kthye andej nga erdhi dhe tha: “Distancohem nga ju; unë përnjëmend shoh atë që ju nuk po e shihni dhe unë i frikësohem Allahut. Dhe Allahu është i rreptë në ndëshkim.”

50. (Kujtojeni) kur hipokritët dhe ata që kishin “sëmundje” në zemra, thoshin: “Këta i ka mashtruar besimi i tyre!” Kurse ai që mbështetet tek Allahu (e di se) Allahu me siguri është i Plotfuqishëm, i Urtë.

51. Sikur t'i shihje kur engjëjt ua merrnin shpirtin atyre që mohuan, ua godisnin fytyrat dhe shpinat

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا لَقِيتُمْ فِئَةً فَاثْبُتُوا وَاذْكُرُوا اللَّهَ كَثِيرًا لَّعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ ﴿٤٦﴾

وَاطِيعُوا اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَلَا تَنَازَعُوا فَتَفْشَلُوا وَتَذْهَبَ رِيحُكُمْ وَاصْبِرُوا ۗ إِنَّ اللَّهَ مَعَ الصَّابِرِينَ ﴿٤٧﴾

وَلَا تَكُونُوا كَالَّذِينَ خَرَجُوا مِنْ دِيَارِهِمْ بَطْرًا وَرِئَاءَ النَّاسِ وَيَصُدُّونَ عَنْ سَبِيلِ اللَّهِ ۗ وَاللَّهُ بِمَا يَعْمَلُونَ مُحِيطٌ ﴿٤٨﴾

وَإِذْ زَيْنٌ لَّهُمُ الشَّيْطَانُ أَعْمَاهُمْ وَقَالَ لَا غَالِبَ لَكُمْ الْيَوْمَ مِنَ النَّاسِ وَإِنِّي جَارٌ لَّكُمْ ۚ فَلَمَّا تَرَأَتِ الْفِئَتَيْنِ نَكَصَ عَلَى عَقَبَيْهِ وَقَالَ إِنِّي بَرِيءٌ مِّنْكُمْ إِنِّي أَرَىٰ مَا لَا تَرَوْنَ إِنِّي أَخَافُ اللَّهَ ۗ بَشِيرٌ وَاللَّهُ شَدِيدُ الْعِقَابِ ﴿٤٩﴾

إِذْ يَقُولُ الْمُنَافِقُونَ وَالَّذِينَ فِي قُلُوبِهِمْ مَّرَضٌ غَرَّ هَؤُلَاءِ دِينُهُمْ ۗ وَمَنْ يَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ فَإِنَّ اللَّهَ عَزِيزٌ حَكِيمٌ ﴿٥٠﴾

وَلَوْ تَرَىٰ إِذْ يَتَوَفَّى الَّذِينَ كَفَرُوا الْمَلَائِكَةُ يَضْرِبُونَ وُجُوهَهُمْ وَأَدْبَارَهُمْ ۗ وَذُوقُوا



(dhe thoshin): “Shijoni ndëshkimin përcëllues!

عَدَابَ الْحَرِيقِ ٥١

52. Kjo për shkak të asaj që (vetë) duart tuaja kanë çuar përpara, kurse Allahu pa dyshim nuk u bën padrejtësi aspak robërve.”

ذَلِكَ بِمَا قَدَّمْتُمْ أَيْدِيكُمْ وَأَنَّ اللَّهَ لَيْسَ بِظَلَّامٍ لِّلْعَبِيدِ ٥٢

53. Ashtu sikurse populli i Faraonit dhe ata që ishin para tyre, (edhe ju silleni njësoj). Ata mohuan ajetet e Allahut, andaj Allahu i zuri për shkak të mëkateve të tyre. Sigurisht, Allahu është i Fuqishëm, i rreptë në ndëshkim.

كَذَابِ آلِ فِرْعَوْنَ ۗ وَالَّذِينَ مِن قَبْلِهِمْ ۗ كَفَرُوا بِآيَاتِ اللَّهِ فَأَخَذَهُمُ اللَّهُ بِذُنُوبِهِمْ ۗ إِنَّ اللَّهَ قَوِيٌّ شَدِيدُ الْعِقَابِ ٥٣

54. Kështu ndodh sepse Allahu kurrë nuk ndërron ndonjë bekim që i ka dhënë ndonjë populli, derisa ata vetë nuk e ndërrojnë veten e tyre. Dhe Allahu është Gjithëdëgjues, i Gjithëdijshëm.

ذَلِكَ بِأَنَّ اللَّهَ لَمْ يَكُ مُعَيَّرًا نِّعْمَةً أُعْتَمِدَهَا عَلَى قَوْمٍ حَتَّى يُعَيَّرُوا مَا بِأَنفُسِهِمْ ۗ وَأَنَّ اللَّهَ سَمِيعٌ عَلِيمٌ ٥٤

55. Ashtu sikurse populli i Faraonit dhe ata që ishin para tyre, (edhe ju silleni njësoj). Ata i quajtën gënjeshtër ajetet e Zotit të tyre, andaj, Ne i shkatërruam për shkak të mëkateve të tyre dhe e fundosëm popullin e Faraonit. Ata të gjithë ishin keqbërës.

كَذَابِ آلِ فِرْعَوْنَ ۗ وَالَّذِينَ مِن قَبْلِهِمْ ۗ كَذَّبُوا بِآيَاتِ رَبِّهِمْ فَأَهْلَكْنَاهُمْ بِذُنُوبِهِمْ وَأَعْرَفْنَا آلَ فِرْعَوْنَ ۗ وَكُلَّ كَاثِرٍ ظَلِيمٍ ٥٥

56. Sigurisht, gjallesat më të këqija tek Allahu janë ata që mohuan dhe nuk kanë për të besuar,

إِنَّ سَرَّ الدَّوَابِّ عِنْدَ اللَّهِ الَّذِينَ كَفَرُوا فَهُمْ لَا يُؤْمِنُونَ ٥٦

57. me të cilët ti bëre besëlidhje, por ata çdo herë e shkelin besën e tyre dhe nuk druhen.

الَّذِينَ عَاهَدْتَ مِنْهُمْ ثُمَّ يَنْقُضُونَ عَهْدَهُمْ فِي كُلِّ مَرَّةٍ وَهُمْ لَا يَتَّقُونَ ٥٧

58. Andaj, nëse ndeshesh me ta në luftë, përmes (shpartallimit të) tyre

فَأَمَّا تَتَقَفَّتْهُمْ فِي الْحَرْبِ فَشَرِّدْهُمْ مِّنْ

shpartalloji edhe ndjekësit e tyre, që të mund të marrin mësim.

خَلَّفَهُمْ لَعَلَّهُمْ يَذَّكَّرُونَ ﴿٥٨﴾

59. Dhe nëse ke frikë nga ndonjë popull për tradhti, kthejua atyre në mënyrë të barabartë. Sigurisht, Allahu nuk i do tradhtarët.

وَأَمَّا تَخَافَنَّ مِنْ قَوْمٍ خِيَانَةً فَانْبِذْ إِلَيْهِمْ عَلَى سَوَاءٍ ۗ إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ

الْخَائِبِينَ ﴿٥٩﴾

60. Le të mos mendojnë mohuesit se (Na) kanë parakaluar. Ata kurrsesi nuk mund të (Na) mundin.

وَلَا يَحْسَبَنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا سَبَقُوا ۗ إِنَّهُمْ

لَا يُعْجِرُونَ ﴿٦٠﴾

61. Dhe ju sa të keni mundësi përgatituni me forcë dhe me kuaj nëpër kufij. Me këto ju do të trembni armikun e Allahut dhe armikun tuaj, si edhe të tjerë përveç tyre. Ju nuk i njihni ata. Allahu i njeh. E çfarëdo gjëje të shpenzoni në rrugën e Allahut, do t'ju kthehet plotësisht, dhe juve nuk do t'ju bëhet padrejtësi.

وَأَعِدُّوا لَهُمْ مَا اسْتَطَعْتُمْ مِنْ قُوَّةٍ وَمِنْ

رِبَاطِ الْخَيْلِ تُرْهِبُونَ بِهِ عَدُوَّ اللَّهِ

وَعَدُوَّكُمْ وَأَخْرَيْنَ مِنْ دُونِهِمْ ۚ لَا

تَعْلَمُونَهُمْ ۚ اللَّهُ يَعْلَمُهُمْ ۗ وَمَا تُنْفِقُوا

مِنْ شَيْءٍ فِي سَبِيلِ اللَّهِ يُوفَّ إِلَيْكُمْ

وَأَنْتُمْ لَا تظَلْمُونَ ﴿٦١﴾

62. E nëse anojnë nga paqja, edhe ti ano për të dhe mbështetu tek Allahu. Sigurisht, Ai është Gjithëdhëguesi, i Gjithëdhijshmi.<sup>12</sup>

وَأِنْ جَاحُوا لِلْسَّلَامِ فَأَجْجِحْ لَهَا وَتَوَكَّلْ

عَلَى اللَّهِ ۗ إِنَّهُ هُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ ﴿٦٢﴾

63. Nëse duan të të mashtrojnë, ty të mjafton Allahu. Është Ai që të përkrahu ty dhe besimtarët me ndihmën e Tij;

وَأِنْ يُرِيدُوا أَنْ يَخْدَعُوكَ فَإِنَّ

حَسْبَكَ اللَّهُ ۗ هُوَ الَّذِي آيَدَكَ بِصِرِهِ

وَأِلَّا مُؤْمِنِينَ ﴿٦٣﴾

12. Ajeti, përveç se vendos një parim të rëndësishëm për lidhjen e traktateve të paqes, hedh dritë edhe mbi karakterin e luftërave të ndërmarra nga Islami. Muslimanët nuk morën armët për t'i konvertuar njerëzit me dhunë në Islam, por për të vendosur dhe ruajtur paqen. Nëse ndonjë popull pasi kishte bërë luftë kundër muslimanëve do të anonte nga paqja, muslimanët ishin të obliguar të mos e refuzonin ofertën, edhe nëse armiku mund të kërkonte paqe vetëm për t'i mashtruar dhe për të fituar kohë. Duke qenë se lufta e tyre ishte vetëm për hir të Zotit, vetëm tek Ai ata duhej të mbështeteshin. Kjo ndër të tjera tregon edhe të vërtetën se deri në çfarë mase shkon Islami për të vendosur paqen midis kombeve.

64. dhe ua bashkoi zemrat. Nëse do të shpenzoje gjithçka që gjendet në tokë, nuk do t'ua bashkoje dot zemrat, por Allahu ua bashkoi. Sigurisht, Ai është i Plotfuqishëm, i Urtë.

وَأَلَّفَ بَيْنَ قُلُوبِهِمْ ۗ لَوْ أَنفَقْتَ مَا فِي  
الْأَرْضِ جَمِيعًا مَّا أَلَّفْتَ بَيْنَ قُلُوبِهِمْ  
وَلَكِنَّ اللَّهَ أَلَّفَ بَيْنَهُمْ ۗ إِنَّهُ عَزِيزٌ  
حَكِيمٌ ﴿١٠﴾

65. O Profet! Të mjafton Allahu ty dhe besimtarët që të ndjekin.

يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ حَسْبُكَ اللَّهُ وَمَنِ اتَّبَعَكَ  
فَجَّ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ ﴿١١﴾

66. O Profet! Nxiti besimtarët për luftë. Nëse ka njëzet durimtarë mes jush, ata do të mundin dyqind. E nëse ka njëqind (durimtarë) mes jush, do të mundin një mijë mohues, sepse ata janë një popull që nuk kuptojnë.<sup>13</sup>

يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ حَرِّضَ الْمُؤْمِنِينَ عَلَى  
الْقِتَالِ ۗ إِنْ يَكُنْ مِنْكُمْ عِشْرُونَ صَابِرُونَ  
يَغْلِبُوا مِائَتِينَ ۚ وَإِنْ يَكُنْ مِنْكُمْ مِائَةٌ  
يَغْلِبُوا أَلْفًا مِنَ الَّذِينَ كَفَرُوا بِأَنَّهُمْ  
قَوْمٌ لَا يَفْقَهُونَ ﴿١٢﴾

67. Tani Allahu e lehtësoi prej jush dhe Ai di që keni dobësi. Andaj, nëse ka njëqind durimtarë mes jush, ata do të mundin dyqind, dhe nëse ka një mijë mes jush, me urdhrin e Allahut ata do të mundin dy mijë. Allahu është me durimtarët.<sup>14</sup>

أَلَنْ خَفَّفَ اللَّهُ عَنْكُمْ وَعَلِمَ أَنَّ فِيكُمْ  
ضَعْفًا ۗ فَإِنْ يَكُنْ مِنْكُمْ مِائَةٌ صَابِرَةٌ  
يَغْلِبُوا مِائَتِينَ ۚ وَإِنْ يَكُنْ مِنْكُمْ أَلْفٌ  
يَغْلِبُوا أَلْفِينَ بِإِذْنِ اللَّهِ ۗ وَاللَّهُ مَعَ  
الصَّابِرِينَ ﴿١٣﴾

13. Profeti Muhammed<sup>savs</sup> u urdhërua t'i nixte besimtarët për luftë. Pavarësisht se ata ishin shumë pak në numër, por Allahu u premtoi që ata do të arrinin të mundnin dhjetëfishin e tyre. Kjo nuk do të thotë se secili prej tyre do t'i bënte ballë dhjetëfishit të tij, madje Zoti e tha për një shumë të caktuar: “nëse jeni njëqind, do të mundni një mijë”, gjë që është plotësisht e mundur.

14. Ky ajet tregon se përkohësisht muslimanët kishin dobësi, pasi nuk patën as ushqim të mjaftueshëm e as armatim të nevojshëm. Andaj, Zoti u tha se tani për tani nëse jeni njëqind, mund të mundni dyqind. Por kur të vendosej fuqia e muslimanëve, mundet që në brezat e ardhshëm një mijë durimtarë prej besimtarëve të mundin dhjetë mijë kundërshtarë. Megjithatë, themeli për fitoret e ardhshme të parashikuara, ishte vënë pikërisht nga besimtarët e parë.

68. Nuk i lejohet një profeti që të mbajë robër, pa bërë gjakderdhje në tokë. Pëlqeni përfitimin e kësaj bote, kurse Allahu pëlqen *ahiretin*. Allahu është i Plotfuqishëm, i Urtë.

69. Po të mos kishte caktim paraprak prej Allahut (që Ai do t'ju falë), do t'ju prekte ndëshkim i madh për shkak të asaj që keni marrë.

70. Ndaj, hani të lejuarën e të pastrën nga ajo që ju vjen si plaçkë lufte dhe kini druajtje ndaj Allahut. Sigurisht, Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

71. O Profet! Robërve të luftës që janë në duart tuaja, thuaju: “Nëse Allahu di për ndonjë mirësi në zemrat tuaja, Ai do t'ju japë (diçka) më të mirë se çka është marrë prej jush dhe do t'ju falë. Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.”

72. Nëse ata duan të të tradhtojnë ty, e kanë tradhtuar edhe Allahun më parë, ndaj, Ai i mposhti ata. Allahu është i Gjithëdijshëm, i Urtë.

73. Sigurisht, ata që besuan, mërguan dhe luftuan me pasuritë dhe jetët e tyre në rrugën e Allahut dhe ata që (i) strehuan (mërgimtarët) dhe ndihmuan, janë miq të njëri-tjetrit. Dhe ata që besuan dhe nuk mërguan, nuk keni aspak të drejtë t'i keni miq, derisa nuk mërgojnë. E nëse ata ju

مَا كَانَ لِنَبِيٍّ أَنْ يَكُونَ لَهُ أَسْرَىٰ حَتَّىٰ يُشْخِنَ فِي الْأَرْضِ ۗ تُرِيدُونَ عَرَصَ الدُّنْيَا ۗ وَاللَّهُ يُرِيدُ الْآخِرَةَ ۗ وَاللَّهُ عَزِيزٌ حَكِيمٌ ﴿٦٨﴾

لَوْلَا كِتَابٌ مِّنَ اللَّهِ سَبَقَ لَمَسَّكُمْ فِيمَا أَخَذْتُمْ عَذَابٌ عَظِيمٌ ﴿٦٩﴾

فَكُلُوا مِمَّا غَنِمْتُمْ حَلَالًا طَيِّبًا ۗ وَاتَّقُوا اللَّهَ ۗ إِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَّحِيمٌ ﴿٧٠﴾

يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ قُلْ لِّمَنْ فِي أَيْدِيكُمْ مِّنَ الْأَسْرَىٰ ۗ إِنْ يَعْلَمِ اللَّهُ فِي قُلُوبِكُمْ خَيْرًا يُؤْتِيكُمْ خَيْرًا مِّمَّا أُخِذَ مِنْكُمْ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ۗ وَاللَّهُ غَفُورٌ رَّحِيمٌ ﴿٧١﴾

وَإِنْ يُرِيدُوا خِيَانَتَكَ فَقَدْ خَانُوا اللَّهَ مِنْ قَبْلُ فَأَمْكَنَ مِنْهُمْ ۗ وَاللَّهُ عَلِيمٌ حَكِيمٌ ﴿٧٢﴾

إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَهَاجَرُوا وَجَاهَدُوا بِأَمْوَالِهِمْ وَأَنْفُسِهِمْ فِي سَبِيلِ اللَّهِ وَالَّذِينَ آوَوْا وَ نَصَرُوا أُولَٰئِكَ بَعْضُهُمْ أَوْلِيَاءُ بَعْضٍ ۗ وَالَّذِينَ آمَنُوا وَلَمْ يَهَاجِرُوا مَا لَكُمْ مِّنْ وَلَايَتِهِمْ مِّنْ شَيْءٍ حَتَّىٰ

kërkojnë ndihmë në besim, e keni për detyrë ndihmën, por jo kundër një populli, mes të cilëve dhe jush ka besë. Allahu është Gjithëshikues për atë që bëni.

74. Ata që mohuan janë miq me njëri-tjetrin. Nëse nuk e zbatoni këtë (që ju është porositur), në tokë do të ketë rrëmujë e trazirë të madhe.

75. Ata që besuan, mërguan dhe luftuan në rrugën e Allahut dhe ata që strehuan dhe ndihmuan janë besimtarët e vërtetë. Ata do të kenë falje dhe dhuratë të nderuar.

76. Ata që besuan më vonë, mërguan dhe luftuan bashkë me ju, janë prej jush. Të farefisit, në Librin e Allahut, janë më të afërt për njëri-tjetrin. Sigurisht, Allahu është i Gjithëdijshëm për çdo gjë.<sup>15</sup>

يٰۤهَاجِرُوۤا۟ ؕ وَاِنۡ اسْتَنْصَرُوۡكُمْ فِى الدِّىۡنِ  
فَعَلَيْكُمْ النُّصْرُ اِلَّا عَلَىٰ قَوْمٍ بَيْنَكُمْ  
وَبَيْنَهُم مِّيثَاقٌ ۗ وَاللّٰهُ بِمَا تَعْمَلُوۡنَ  
بَصِيۡرٌ ﴿٧٤﴾

وَالَّذِيۡنَ كَفَرُوۡا بَعْضُهُمۡ اَوْلِيَآءُ بَعْضٍ ۗ اِلَّا  
تَفْعَلُوهُ تَكُنۡ فِتْنَةٌ فِى الْاَرْضِ وَفَسَادٌ  
كَبِيۡرٌ ﴿٧٥﴾

وَالَّذِيۡنَ اٰمَنُوۡا وَهَاجَرُوۡا وَجِهَدُوۡا فِى  
سَبِيْلِ اللّٰهِ وَالَّذِيۡنَ اٰوَاوۡا وَنَصَرُوۡا اَوْلِيَآءَ  
هُمُ الْمُؤْمِنُوۡنَ حَقًّا ۗ لَهُم مَّغْفِرَةٌ وَّرِزْقٌ  
كَرِيۡمٌ ﴿٧٦﴾

وَالَّذِيۡنَ اٰمَنُوۡا مِنْۢ بَعْدِ وَهَاجَرُوۡا وَجِهَدُوۡا  
مَعَكُمْ فَاُولٰٓئِكَ مِنْكُمْ ۗ وَاُولُوا الْاَرْحَامِ  
بَعْضُهُمْ اَوْلٰى بِبَعْضٍ فِى كِتٰبِ اللّٰهِ ۗ اِنَّ اللّٰهَ  
لَعَلِيۡمٌ ﴿٧٧﴾

15. Meqenëse Kurani deklaroi se të gjithë muslimanët që mërguan, si dhe ata që i pritën mërgimtarët, ishin një bashkësi (8:73), Profeti i Shenjtë<sup>savs</sup> vendosi vëllazëri midis muhaxhirëve mekas dhe *ensarëve* medinas. Kjo mund të krijonte keqkuptimin se ata mund të trashëgonin edhe pronën e njëri-tjetrit. Ky ajet sqaron se vetëm lidhjet e gjakut kanë të drejtë në trashëgimi dhe se muslimanët e tjerë janë vetëm vëllezër në besim.

## Surja 9 – Et-Teube

Surja Et-Teube [që quhet edhe Beraet] u zbrit në Medinë, pas zbritjes së sures El-Enfal. Ajo ka njëqind e njëzet e nëntë ajete.

Çështjet që mund të lindnin për shkak të luftërave, të sprovave e të bekimeve si pasojë luftërash, të cilat përmenden në fund të sures El-Enfal, kjo sure i përmend që në krye të saj. Armiku do të mundet patjetër dhe do të detyrohet të bëjë marrëveshje me Profetin Muhammed<sup>savs</sup> dhe sahabët e tij. Andaj, standardi i drejtësisë për muslimanët është që nuk duhet të shkelin marrëveshjen për sa kohë që kundërshtarët i përmbahen asaj.

Rrëfimet për pasojat e besëlidhjes në forma të ndryshme i kemi parë nga surja El-Fatiha e deri edhe në suren El-Enfal. Edhe surja Et-Teube e përmend këtë temë, por njëherësh thotë se ashtu siç kundërshtarët dënohen për tradhtitë e tyre, edhe besimtarët nuk duhet të mendojnë se kanë imunitet nga një gjë e tillë, përkundrazi.

Në këtë sure flitet shpesh se sukseset e besimtarëve nuk vijnë si rrjedhojë e cilësisë së armëve ose e numrit të trupave të tyre dhe as nuk do të ndodhë një gjë e tillë edhe në të ardhmen. Në këtë kontekst përmendet beteja e Hunejnit, kur muslimanët kishin një numër shumë më të madh ushtarësh në krahasim me mohuesit, dhe kur disa muslimanë për këtë shkak e shihnin të sigurt fitoren e tyre, Zoti u dha mësim: Kur ishit të paktë, gjithmonë keni fituar për shkak të lutjeve të Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, andaj, këtë herë duhet thyer mburrja juaj që keni krijuar për numrin. Kështu që, do të fitoni vetëm pas një humbjeje të thellë, fitore e cila me bekimin e Zotit, sërish do të vijë për shkak të lutjeve, të durimit dhe të kurajës së këtij Profeti<sup>savs</sup>.

Pas kësaj, flitet për pasuritë e bollshme që do t'u jepen muslimanëve, aq saqë hipokritët ziliqarë do ta akuzojnë Profetin Muhammed<sup>savs</sup>, *ma'adhallah*, për pandershmëri, ndërkohë, çdo pasuri që i vinte Profetit<sup>savs</sup>, ai nuk ua jepte të afërmve të vet, por muhaxhirëve, të varfërve, nevojtarëve, të shtypurve dhe njerëzve që ishin të rënduar nga borxhet e shumta. Andaj, u është bërë vërejtje se nëse e akuzoni këtë të Dërguar të ndershëm për pandershmëri, do të shkatërroheni. E vërteta ishte që janë pikërisht akuzuesit në fjalë që ishin të përfshirë në korrupsion.

Në fund të kësaj sureje vjen ajeti që thotë se ky i Dërguar është ai që vihet në vështirësi për t'ju bërë mirësi juve dhe atij i vjen shumë rëndë kur ju jeni vështirësi në rrugën e Allahut dhe se shtrëngimi ndaj mohuesve nuk lidhet me shtrëngimin e zemrës së tij; zemra e tij është kaq e mëshirshme dhe e dhembshur, saqë ai është shembulli i gjallë i Zotit të Dhembshur e Mëshirëbërës.



1. Distançim (vjen) nga ana e Allahut dhe e të Dërguarit të Tij për idhujtarët me të cilët keni bërë marrëveshje.<sup>1</sup>

2. Ndaj, shëtisni katër muaj në tokë dhe dijeni se ju kurrresi nuk mund ta mundni Allahun dhe se Allahu me siguri do t'i poshtërojë mohuesit.<sup>2</sup>

3. Dhe thirrje (vjen) nga ana e Allahut dhe e të Dërguarit të Tij për njerëzit ditën e haxhit të madh<sup>3</sup> se Allahu është distancuar, gjithashtu edhe i Dërguari i Tij, nga idhujtarët. Nëse pendoheni, do të jetë mirë për ju. E nëse e ktheni shpinën, dijeni se kurrresi nuk mund ta mundni Allahun. Atyre që mohuan, jepu lajmin e një ndëshkimi të dhimbshëm.

بَرَاءَةٌ مِّنَ اللَّهِ وَرَسُولِهِ إِلَى الَّذِينَ  
عَاهَدْتُمْ مِّنَ الْمُشْرِكِينَ ۝

فَسِيحُوا فِي الْأَرْضِ أَرْبَعَةَ أَشْهُرٍ وَاعْلَمُوا  
أَنَّكُمْ عَيْرُ مُعْجِزِي اللَّهِ ۗ وَأَنَّ اللَّهَ  
مُخْزِي الْكَافِرِينَ ۝

وَإِذْ قَالَ مِّنَ اللَّهِ وَرَسُولِهِ إِلَى النَّاسِ  
يَوْمَ الْحَجِّ الْأَكْبَرِ أَنَّ اللَّهَ بَرِيءٌ مِّنَ  
الْمُشْرِكِينَ ۗ وَرَسُولُهُ ۗ فَإِن تُبْتُمْ فَهُوَ  
خَيْرٌ لَّكُمْ ۚ وَإِن تَوَلَّيْتُمْ فَاعْلَمُوا أَنَّكُمْ  
عَيْرُ مُعْجِزِي اللَّهِ ۗ وَبَشِّرِ الَّذِينَ كَفَرُوا  
بِعَذَابٍ أَلِيمٍ ۝

1. Duhet thënë që surja Et-Teube nuk fillon me *bismil-lah*. Kurani gjithsej ka 114 sure dhe 113 prej tyre fillojnë me ajetin *bismil-lah*. Megjithatë, është mrekullia e Kuranit që në suren En-Neml, Zoti përmend dy herë *bismil-lahin*, një herë në fillim të saj, dhe herën e dytë duke iu referuar letrës së *Hazret Sulejmanit* (27:31). Në këtë mënyrë, edhe *bismil-lahi* përmendet plot 114 herë në Kuran. Lexoni edhe 2:1.

2. Me rënien e Mekës dhe humbjen e fisit Havazin në Betejën e Hunejnit, sundimi dhe autoriteti i Islamit ishte vendosur në të gjithë Hixhazin (Arabia perëndimore). Disa fise kishin bërë traktate me muslimanët dhe kishin ulur armët. Këto traktate duhej të respektoheshin plotësisht. Por kishte fise të tjera që nuk ishin nënshtruar formalisht, nuk kishin ulur armët dhe gjithashtu nuk kishin bërë asnjë marrëveshje me muslimanët për të siguruar ruajtjen e paqes dhe respektimin e rendit dhe të ligjit. Ata kishin filluar armiqësi kundër muslimanëve dhe megjithëse në fakt ishin mundur, ende nuk e kishin pranuar humbjen dhe as nuk kishin pranuar të jetonin në paqe me muslimanët. Këtyre fiseve iu dha një periudhë pushimi katërmujore, gjatë së cilës operacionet kundër tyre do të mbeteshin të pezulluara. Ata mund të lëviznin lirshëm në vend, që të bindeshin se rezistenca e mëtejshme ishte e kotë. Më pas ata mund të lëshonin armët dhe të bënin traktat paqeje. Pikërisht këtyre fiseve u referohet ky ajet.

3. U quajt *haxh i madh* sepse ishte pelegrinazhi i parë i haxhit, i realizuar nën organizimin e muslimanëve.

4. Përveç atyre prej idhujtarëve, me të cilët bëtë marrëveshje e më pas ata nuk e shkelën aspak dhe as nuk ndihmuan ndokënd kundër jush. Andaj, përmbusheni marrëveshjen me ta deri në afatin e saj. Sigurisht, Allahu i do të druajturit (ndaj Tij).<sup>4</sup>

5. Kur të kalojnë muajt e shenjtë,<sup>5</sup> luftoni me idhujtarët kudo që t'i gjeni dhe kapini, rrethojini dhe u qëndroni në çdo pritë.<sup>6</sup> Nëse ata pendohen, falin namazin, japin zekatin, lirojuani rrugën. Pa dyshim, Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.<sup>7</sup>

6. E nëse ndonjë prej idhujtarëve të kërkon strehim, strehoje gjersa ai të dëgjojë fjalën e Allahut e më pas çojë

إِلَّا الَّذِينَ عَاهَدْتُمْ مِنَ الْمُشْرِكِينَ ثُمَّ لَمْ يَنْقُصُوكُمْ شَيْئًا وَ لَمْ يُظَاهِرُوا عَلَيْكُمْ أَحَدًا فَأَتِمُّوا إِلَيْهِمْ عَهْدَهُمْ إِلَىٰ مَدَّتِهِمْ ۗ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُتَّقِينَ ۝

فَإِذَا انْسَلَخَ الْأَشْهُرُ الْحُرْمُ فَاقْتُلُوا الْمُشْرِكِينَ حَيْثُ وَجَدْتُمُوهُمْ وَخُذُوهُمْ وَأَحْضِرُوا لَهُمْ كُلَّ مَرْصِدٍ ۚ فَإِن تَابُوا وَأَقَامُوا الصَّلَاةَ وَآتَوُا الزَّكَاةَ فَخَلُّوا سَبِيلَهُمْ ۗ إِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَّحِيمٌ ۝

وَإِن أَحَدٌ مِّنَ الْمُشْرِكِينَ اسْتَجَارَكَ فَأَجِرْهُ حَتَّىٰ يَسْمَعَ كَلِمَةَ اللَّهِ ثُمَّ أَبْلِغْهُ

4. Këto fise ishin Benu Khuza'ah, Benu Mudlixh, Benu Bekr, Benu Demreh dhe disa nga nënfishet e Benu Sulejmit. Ajeti gjithashtu hedh dritë edhe mbi shenjtërinë që Islami u jep traktateve dhe marrëveshjeve.

5. "Muajt e shenjtë" (muajt e ndaluar) janë Dhul Kade, Dhul Hixhe, Muharrem dhe Rexheb (Buhari, nr. 3197). Tre të parët janë muajt e haxhit, ndërsa në të fundit arabët në përgjithësi kryenin umranë (2:195 dhe 2:218). Duhet thënë se termi *El-Eshhurul-hurum*, që në përgjithësi përkthehet si "muajt e shenjtë", në fakt janë "muajt e ndaluar", në të cilët lufta ishte e ndaluar. Për këtë arsye, edhe idhujtarëve të lartpërmendur Kurani u dha mbrojtjen që ata të udhëtonin në vend për të parë vetë nëse Islami kishte triumfuar apo jo dhe nëse fjala e Zotit ishte përmbushur apo jo. Gjatë kësaj periudhe, duhej pezulluar çdo luftë, dhe pastaj, lufta do të rifillonte kundër armiqve të shpallur të Islamit, të cilët e kishin nisur luftën të parët dhe deshën ta vijonin atë duke prishur traktatet në mënyrë të përsëritur. Arsyeja e këtij ultimatumit jepet në 9:8-13. Sa për ata idhujtarë që nuk ishin fajtorë për pabesi e tradhti, ata duhej të mbroheshin (9:4 dhe 7).

6. Ata idhujtarë që kishin luftuar me muslimanët dhe nuk kishin kërkuar ende një marrëveshje paqeje me ta.

7. Nëse i studioni me vëmendje këto ajete, do të kuptoni se ato nuk kërkojnë dhunë në fe, përkundraz, edhe për ata idhujtarë mekas të cilët nuk lanë mjet pa përdorur për të persekutuar e dhunuar muslimanët burra, gra e fëmijë, dhe që meritonin të dënoheshin me vdekje, e nëse do të zbatohesh sheriati i Musait, dënimi i tyre do të ishte që t'u vriteshin edhe burrat, edhe gratë edhe fëmijët, prapëseprapë feja Islame u dha një mundësi të fundit, vetëm duke i mëshiruar: çdokush prej tyre nëse e pranonte Islamit me dëshirën e vet, do të ishte në paqe.



në vendin e tij të sigurt. Kjo sepse ata janë një popull që nuk dinë.<sup>8</sup>

﴿ مَا مَنَّهُ ۖ ذَٰلِكَ بِأَنَّهُمْ قَوْمٌ لَا يَعْلَمُونَ ۝٨﴾

7. Si mund të jetë e mirëqenë marrëveshja e idhujtarëve tek Allahu dhe tek i Dërguari i Tij, përveç atyre, me të cilët ju lidhët marrëveshje në Xhaminë e shenjtë?! Pra, derisa ata qëndrojnë (në marrëveshje) për dobinë tuaj, edhe ju qëndroni për dobinë e tyre. Sigurisht, Allahu i do ata që janë të druajtur (ndaj Tij).<sup>9</sup>

كَيْفَ يَكُونُ لِلْمُشْرِكِينَ عَهْدٌ عِنْدَ اللَّهِ وَعِنْدَ رَسُولِهِ إِلَّا الَّذِينَ عَاهَدْتُمْ عِنْدَ الْمَسْجِدِ الْحَرَامِ ۚ فَمَا اسْتَقَامُوا لَكُمْ فَاسْتَقِيمُوا لَهُمْ ۗ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُتَّقِينَ ۝٩﴾

8. Si mund të jetë (e besueshme marrëveshja e tyre), ndërkohë nëse ata ju mbizotërojnë, nuk do të kenë në konsideratë as marrëveshje e as përgjegjësi?! Ju kënaqin vetëm me gojët e tyre, kurse zemrat e tyre mohojnë, dhe shumica e tyre janë të ligj.

كَيْفَ وَإِنْ يَظْهَرُوا عَلَيْكُمْ لَا يَقْبَلُوا فِيكُمْ إِلَّا وَلَا ذِمَّةٌ ۗ يُرْضُونَكُمْ بِأَفْوَاهِهِمْ وَتَأْبَىٰ قُلُوبُهُمْ ۗ وَآكُثْرُهُمْ فَسِقُونَ ۝٨﴾

9. Ata këmbyen ajetet e Allahut me çmim të vogël. Pra, penguan nga rruga e Tij. Sa e keqe është ajo që bëjnë!

إِشْتَرَوْا بِآيَاتِ اللَّهِ ثَمًّا قَلِيلًا ۖ فَصَدُّوا عَن سَبِيلِهِ ۗ إِنَّهُمْ سَاءَ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ۝٩﴾

8. Është e qartë nga ky ajet se Kurani i Shenjtë po të jepte mësimin e dhunës, nuk do të kërkonte që një idhujtari të tillë t'i jepej mundësia për t'u kthyer i sigurt në vendin e tij, përkundrazi, do t'u thoshte muslimanëve mos e lejoni të largohet pa u bërë musliman. Dhe fjalët e fundit të këtij ajeti e tregojnë edhe arsyen se idhujtarëve të tillë duhej t'u jepnin lehtësi të tillë, sepse ata nuk e dinë të vërtetën për fenë Islame.

9. Ajeti tregon se lufta ishte e lejuar vetëm kundër atyre jomuslimanëve, të cilët në mënyrë të përsëritur kishin shkëlur traktatet dhe i kishin sulmuar muslimanët pabesisht. Për sa i përket pjesës tjetër, muslimanëve u ishte kërkuar që t'i respektonin marrëveshjet me ta në mënyrë rigoroze. Ashtu si 9:4, edhe ky ajet përshkruan respektimin e besëlidhjeve dhe të traktateve si një akt devotshmërie e drejtësie dhe kusht për të fituar dashurinë e Allahut. Kurani në mënyrë të përsëritur dhe të prerë i nxit muslimanët që të jenë besnikë ndaj traktateve të tyre.

10. Nuk marrin në konsideratë për asnjë besimtar as marrëveshje e as përgjegjësi. Pikërisht këta e shkelin kufirin.<sup>10</sup>

11. Nëse pendohen, falin namazin dhe japin zekatin, janë vëllezërit tuaj në besim. Ne i shtjellojmë ajetet për njerëzit që dinë.

12. Pas marrëveshjes së tyre, nëse ata i shkelin premtimet dhe sulmojnë fenë tuaj,<sup>11</sup> luftoni me prijësit mohues. Ata nuk i mbajnë fare premtimet, (andaj, luftoni që) ndoshta heqin dorë.

13. A nuk do të luftoni me njerëzit që shkelën premtimet e tyre, vendosën ta dëbojnë të Dërguarin dhe janë pikërisht ata që e nisën ndaj jush për herë të parë?! A do t'u frikësoheni atyre?! Atëherë Allahu ka më shumë të drejtën që t'i frikësoheni Atij, në qoftë se jeni besimtarë.<sup>12</sup>

لَا يَرْقُبُونَ فِي مُؤْمِنٍ إِلَّا وَا لَا ذِمَّةً<sup>ط</sup>  
وَأُولَئِكَ هُمُ الْمُعْتَدُونَ<sup>١٠</sup>

فَإِنْ تَابُوا وَأَقَامُوا الصَّلَاةَ وَآتَوُا الزَّكَاةَ  
فَإِخْوَانُكُمْ فِي الدِّينِ<sup>ط</sup> وَنُقِصَلُ الْآيَاتِ  
لِقَوْمٍ يَعْلَمُونَ<sup>١١</sup>

وَإِنْ نَكَثُوا أَيْمَانَهُمْ مِنْ بَعْدِ عَهْدِهِمْ  
وَطَعَنُوا فِي دِينِكُمْ فَقَاتِلُوا أُمَّةَ الْكُفْرِ<sup>ل</sup>  
إِنَّهُمْ لَا آيْمَانَ لَهُمْ لَعَلَّهُمْ يَنْتَهُونَ<sup>١٢</sup>

أَلَا تُقَاتِلُونَ قَوْمًا نَكَثُوا أَيْمَانَهُمْ  
وَهُمُؤَا بِإِخْرَاجِ الرَّسُولِ وَهُمْ بَدَّوْكُمْ  
أَوَّلَ مَرَّةٍ<sup>ط</sup> أَتَخْشَوْنَهُمْ<sup>ج</sup> فَاللَّهُ أَحَقُّ أَنْ  
تَخْشَوْهُ إِنْ كُنْتُمْ مُؤْمِنِينَ<sup>١٣</sup>

10. Ky dhe dy ajetet e mëparshme japin arsyt pse Zoti i urdhëroi muslimanët të luftonin kundër idhujtarëve të tillë (9:5). Arsyet janë: (1) Ata ishin të pabesë dhe shkelës të traktateve; ata deklaruan se ishin miq me muslimanët, por sapo gjetën mundësinë për t'i lënduar ata, e thyen fjalën dhe iu bënë armiq, pavarësisht se muslimanët u kishin besuar. (2) Ata madje shpërfillën edhe lidhjet farefisnore dhe vranë të afërmit e tyre vetëm sepse këta të fundit kishin përqaftuar Islamin (9:8). (3) Qëllimi i tyre në luftë ishte që t'i pengonin njerëzit të përqaftonin Islamin (9:9). (4) Ishin të parët që sulmuan muslimanët (9:13).

11. Fjalët "sulmojnë fenë tuaj" nënkuptojnë jo vetëm talljet dhe dhunën verbale, por edhe sulmet fizike të tyre që synonin të dëmtojnë interesat jetike të Islamit. Fjala arabe *ta'ane* që është përdorur në këtë ajet, fjalë për fjalë do të thotë "të shposh dikë me shtizë". Lexoni edhe 9:13.

12. Ky ajet tregon se nuk ishin muslimanët që e filluan luftën të parët, por kundërshtarët e tyre. Dhe përpara se të sulmonin, ata i persekutuan muslimanët, i vranë barbarisht, i detyruan ta braktisnin vendin, i ndoqën dhe i përndoqën. Dhe të gjitha këto i quanin fitore e lavdi të idhujve të tyre. Në këtë situatë, çfarë rruge tjetër, vallë, mund t'i kishte mbetur muslimanëve, përveçse t'u kundërpërgjigjeshin me dhëmbë e me hekur!

14. Luftojini, Allahu do t'i ndëshkojë ata me duart tuaja, do t'i poshtërojë, do t'ju ndihmojë kundër tyre dhe do t'i shërojë zemrat e popullit besimtar.

قَاتِلُوهُمْ يُعَذِّبُهُمُ اللَّهُ بِأَيْدِيكُمْ وَيُخْزِهِمْ  
وَيَبْصُرْكُمْ عَلَيْهِمْ وَيَشْفِ صُدُورَ قَوْمٍ  
مُؤْمِنِينَ ۝١٤

15. Dhe do t'u largojë zemërimin e zemrave të tyre. Allahu i pranon pendesën kujt të dojë. Dhe Allahu është i Gjithëdijshëm, i Urtë.

وَ يَذْهَبْ غَيْظَ قُلُوبِهِمْ ۗ وَيُتُوبُ اللَّهُ  
عَلَىٰ مَنْ يَشَاءُ ۗ وَاللَّهُ عَلِيمٌ حَكِيمٌ ۝١٥

16. A menduat se ju do të liheni, kurse Allahu ende nuk ka dalluar mes jush ata që luftuan dhe nuk morën si shok të ngushtë askënd tjetër përveç Allahut, të Dërguarit të Tij dhe besimtarëve?! Allahu është i Gjithinformuar për atë që bëni.

أَمْ حَسِبْتُمْ أَنْ تُتْرَكُوا وَلَمَّا يَعْلَمِ اللَّهُ  
الَّذِينَ جَاهَدُوا مِنْكُمْ وَلَمْ يَتَّخِذُوا مِنْ  
دُونِ اللَّهِ وَلَا رَسُولِهِ وَلَا الْمُؤْمِنِينَ  
بِغِيٍّ وَلَا حِجَّةٍ ۗ وَاللَّهُ خَبِيرٌ بِمَا تَعْمَلُونَ ۝١٦

17. Nuk është për idhujtarët të popullojnë xhamitë e Allahut, ndërkohë ata janë dëshmitarë të mohimit kundër vetes së tyre. Këtyre u dështuan veprat dhe në zjarr do të qëndrojnë gjatë.

مَا كَانَ لِلْمُشْرِكِينَ أَنْ يَعْمُرُوا مَسْجِدَ اللَّهِ  
شَاهِدِينَ عَلَىٰ أَنْفُسِهِمْ بِالْكَفْرِ ۗ أُولَٰئِكَ  
حَبِطَتْ أَعْمَالُهُمْ ۗ وَفِي النَّارِ هُمْ  
خَالِدُونَ ۝١٧

18. Xhamitë e Allahut i popullon ai që beson Allahun, Ditën e *Ahiretit*, fal namazin, jep zekatin dhe nuk i frikësohet askujt tjetër përveç Allahut. Të tillët mund të bëhen ndër të udhëzuarit.

إِنَّمَا يَعْمُرُ مَسْجِدَ اللَّهِ مَنْ آمَنَ بِاللَّهِ  
وَالْيَوْمِ الْآخِرِ وَأَقَامَ الصَّلَاةَ وَآتَى الزَّكَاةَ  
وَلَمْ يَخْشَ إِلَّا اللَّهَ ۗ فَعَسَىٰ أُولَٰئِكَ أَنْ  
يَكُونُوا مِنَ الْمُهْتَدِينَ ۝١٨

19. Dhënien e ujit haxhinjve dhe kujdesin e Xhamisë së shenjtë a i barazuat me atë që beson Allahun, Ditën e *Ahiretit* dhe lufton në rrugën e Allahut?! Këto nuk janë të barabarta tek Allahu. Allahu nuk i

أَجَعَلْتُمْ سِقَايَةَ الْحَاجِّ وَعِمَارَةَ الْمَسْجِدِ  
الْحَرَامِ كَمَنْ آمَنَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ  
وَجَاهَدَ فِي سَبِيلِ اللَّهِ ۗ لَا يَسْتَوُونَ عِنْدَ اللَّهِ ۗ

udhëzon njerëzit e padrejtë.<sup>13</sup>

وَاللَّهُ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الظَّالِمِينَ ﴿١٣﴾

20. Ata që besuan, mërguan dhe luftuan në rrugën e Allahut me pasurinë dhe jetët e tyre kanë pozitën më të madhe tek Allahu. E pikërisht ata janë të suksesshmit.

الَّذِينَ آمَنُوا وَهَاجَرُوا وَجَاهَدُوا فِي سَبِيلِ  
اللَّهِ بِأَمْوَالِهِمْ وَأَنْفُسِهِمْ ۖ أَعْظَمَ دَرَجَةً  
عِنْدَ اللَّهِ ۗ وَأُولَٰئِكَ هُمُ الْفَائِرُونَ ﴿٢٠﴾

21. Zoti i tyre u jep sihariqin e mëshirës prej Tij, të pëlqimit dhe të kopshteve për ta, në të cilat ka bekime të qëndrueshme.

يُبَشِّرُهُمْ رَبُّهُمْ بِرَحْمَةٍ مِنْهُ وَرِضْوَانٍ  
وَجَنَّتٍ لَهُمْ فِيهَا نَعِيمٌ مُّقِيمٌ ﴿٢١﴾

22. Ata në to do të jetojnë përgjithmonë. Sigurisht, tek Allahu ka shpërblim madhor.

خَالِدِينَ فِيهَا أَبَدًا ۗ إِنَّ اللَّهَ عِنْدَهُ أَجْرٌ  
عَظِيمٌ ﴿٢٢﴾

23. O ju që besuat! Mos i bëni shokë baballarët dhe vëllezërit tuaj, nëse ata parapëlqyen mohimin në vend të besimit. Prej jush ata që i bëjnë shokë, janë të padrejtë.<sup>14</sup>

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَتَّخِذُوا آبَاءَكُمْ  
وَإِخْوَانَكُمْ أَوْلِيَاءَ ۗ إِنِ اسْتَحَبُّوا الْكُفْرَ  
عَلَى الْإِيمَانِ ۗ وَمَنْ يَتَوَلَّهُمْ مِنْكُمْ  
فَأُولَٰئِكَ هُمُ الظَّالِمُونَ ﴿٢٣﴾

24. Thuaju: Baballarët tuaj, djemtë tuaj, vëllezërit tuaj, bashkëshortët tuaj, farefisi juaj, pasuria që fitoni, tregtia, humbja në të cilën ju frikëson, shtëpitë që ju i pëlqeni, nëse janë më të dashura tek ju sesa Allahu, i Dërguari i Tij dhe xihadi në rrugën e Tij, atëherë prisni derisa Allahu të sjellë vendimin e Tij. Allahu

قُلْ إِن كَانَ آبَاؤُكُمْ وَأَبْنَاؤُكُمْ  
وَإِخْوَانُكُمْ وَأَزْوَاجُكُمْ وَعَشِيرَتُكُمْ  
وَأَمْوَالٌ اقْتَرَفْتُمُوهَا وَتِجَارَةٌ تَخْشَوْنَ  
كَسَادَهَا وَمَسَاكِينُ تَرْضَوْنَهَا أَحَبَّ  
إِلَيْكُمْ مِنَ اللَّهِ وَرَسُولِهِ وَجِهَادٍ فِي  
سَبِيلِهِ فَتَرَبَّصُوا حَتَّى يَأْتِيَ اللَّهُ بِأَمْرِهِ ۗ

13. Mirëmbajtja e Qabesë ndonëse një vepër fisnike, nuk është gjë në krahasim me mbrojtjen e qëllimit për të cilin ajo është ndërtuar, shërbim të cilin vetëm një musliman i vërtetë mund ta kryejë. Ajeti thekson se Islami i kushton rëndësi më të madhe shpirtit a frymës që qëndron në themel të urdhëresave të tij, sesa anës formale.

14. Ajeti i referohet asaj pjesë të mohuesve të cilët merrnin pjesë në veprimtari armiqësore ndaj Islamit dhe përpiqeshin për ta asgjësuar atë. Lexoni edhe 60:9-10.

nuk udhëzton njerëzit e ligj.<sup>15</sup>

وَاللَّهُ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الْفَاسِقِينَ ﴿١٥﴾

25. Sigurisht, Allahu ju ka ndihmuar në shumë fushëbeteja dhe (sidomos) ditën e Hunejnit, kur numri juaj i shumtë ju bëri të mburreni, por kjo nuk ju vlejti aspak, dhe toka pavarësisht se ishte e gjerë, ju u bë e ngushtë. Më pas vrapuat duke e kthyer shpinën.

لَقَدْ نَصَرَكُمُ اللَّهُ فِي مَوَاطِنَ كَثِيرَةٍ ۗ<sup>١٥</sup>  
وَيَوْمَ حُنَيْنٍ ۗ إِذْ أَعْجَبَتْكُمْ كَثْرَتُكُمْ فَلَمْ  
تُغْنِ عَنْكُمْ شَيْئًا وَصَافَتْ عَلَيْكُمْ الْأَرْضُ  
بِمَا رَحَبَتْ ۗ لَمَّا وَلَّيْتُمْ مُدَبِّرِينَ ﴿١٥﴾

26. Pastaj, Allahu zbriti qetësinë e Tij mbi të Dërguarin e Tij dhe mbi besimtarët, zbriti një ushtri që nuk e shikonit dhe i ndëshkoi ata që mohuan. I tillë është shpërblimi i mohuesve.

ثُمَّ أَنْزَلَ اللَّهُ سَكِينَتَهُ عَلَى رَسُولِهِ وَعَلَى  
الْمُؤْمِنِينَ وَأَنْزَلَ جُودًا لَمَّا تَرَوْهَا  
وَعَذَّبَ الَّذِينَ كَفَرُوا ۗ وَذَلِكَ جَزَاءُ  
الْكَافِرِينَ ﴿١٦﴾

27. E pas kësaj, Allahu i pranon pendesën kujt të dojë. Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

ثُمَّ يَتُوبُ اللَّهُ مِنْ بَعْدِ ذَلِكَ عَلَى مَنْ  
يَشَاءُ ۗ وَاللَّهُ عَفُورٌ رَحِيمٌ ﴿١٧﴾

28. O ju që besuat! Idhujtarët pa dyshim janë të papastër. Andaj, ata le të mos i afrohen Xhamisë së shenjtë pas këtij viti.<sup>16</sup> Nëse keni frikë nga varfëria, Allahu do t'ju pasurojë përmes bekimit të Tij, nëse do Ai. Sigurisht, Allahu është i Gjithëdijshëm, i Urtë.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِنَّمَا الْمُشْرِكُونَ نَجَسٌ  
فَلَا يَقْرَبُوا الْمَسْجِدَ الْحَرَامَ بَعْدَ عَامِهِمْ  
هَذَا ۗ وَإِنْ خِفْتُمْ عَيْلَةً فَسَوْفَ يُعْنِيكُمْ  
اللَّهُ مِنْ فَضْلِهِ ۗ إِنْ شَاءَ ۗ إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ  
حَكِيمٌ ﴿١٨﴾

15. I Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> tha: “Betohem për Atë Zot në duart e të cilit është jeta ime, askush nga ju nuk është besimtar, derisa të më dojë më shumë se babain dhe fëmijët e tij.” (Buhari, nr. 14).

16. “Idhujtarët janë të papastër”. Papastërtia e tyre i referohet besimit të tyre dhe jo papastërtisë së trupit. Andaj, kur thuhet se idhujtarët nuk lejohen të hyjnë në Xhaminë e Shenjtë, do të thotë se ata nuk lejohen të bëjnë haxh me zakonet e tyre të idhujtarisë. Në kohën para Islamit, ata merrnin idhujt e tyre dhe bënin haxh, nganjëherë edhe lakuriq. Kështu që, sipas *Hazret Imam Ebu Hanifes*<sup>a</sup> dhe po ashtu edhe sipas fikhologëve të tjerë hanefi, idhujtarët mund të hyjnë në çdo xhami të muslimanëve, duke e përfshirë edhe Xhaminë e Shenjtë (Qabeja), por atje nuk lejohen t'i kryejnë zakonet e tyre të idhujtarisë (Zuhejli, “El-Fikh ...”, f. 434-435).

29. Luftoni me ata ithtarë të Librit që nuk e besojnë as Allahun e as Ditën e *Ahiretit*, nuk e quajnë të ndaluar atë që Allahu dhe i Dërguari i Tij e ndalojnë dhe nuk e pranojnë fenë e vërtetë si fe, derisa të japin me dorë *xhizjen*, duke u mundur.

30. Hebrenjtë thanë: “Uzejri është i biri i Allahut” dhe të krishterët thanë: “Mesihu është i biri i Allahut”. Këto janë fjalë goje të tyre. Ata ndjekin fjalën e atyre që mohonin para tyre. I vraftë Allahu, si shmangen!

31. Ata i morën dijetarët dhe murgjit e vet si zota pos Allahut, (gjithashtu) edhe Mesihun, birin e Merjemes, ndërkohë atyre u ishte urdhëruar vetëm të adhuronin një të Adhuruar të Vetëm. Nuk ka të adhurueshëm tjetër përveç Atij. I pastër është Ai nga ortakëria që ata i bëjnë.

32. Duan ta shuajnë dritën e Allahut me gojët e tyre dhe Allahu refuzon (çdo gjë) përveçse ta përsosë dritën e Tij, sado që urrejnë mohuesit.

33. Është Ai që dërgoi të Dërguarin e Tij me udhëzimin dhe fenë e vërtetë, që ta triumfojë atë mbi të gjitha fetë, sado që urrejnë idhujtarët.<sup>17</sup>

34. O ju që besuat! Ka plot dijetarë dhe murgj që hanë pasurinë e njerëzve padrejtësisht dhe pengojnë nga rruga

قَاتِلُوا الَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَلَا  
بِالْيَوْمِ الْآخِرِ وَلَا يُحَرِّمُونَ مَا حَرَّمَ اللَّهُ  
وَرَسُولُهُ وَلَا يَدِينُونَ دِينَ الْحَقِّ مِنَ  
الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ حَتَّى يُعْطُوا الْجِزْيَةَ  
عَنْ يَدٍ وَهُمْ صَاغِرُونَ ﴿٢٩﴾

وَقَالَتِ الْيَهُودُ عُزَيْرٌ ابْنُ اللَّهِ وَقَالَتِ  
النَّصَارَى الْمَسِيحُ ابْنُ اللَّهِ ۗ ذَلِكَ قَوْلُهُمْ  
بِأَفْوَاهِهِمْ ۗ يَصَاهُجُونَ قَوْلَ الَّذِينَ كَفَرُوا  
مِنْ قَبْلُ ۗ قَتَلَهُمُ اللَّهُ ۗ أَلَىٰ يُؤْفَكُونَ ﴿٣٠﴾

اتَّخَذُوا أَحْبَارَهُمْ وَرُهَبَانَهُمْ أَرْبَابًا  
مِّنْ دُونِ اللَّهِ وَالْمَسِيحَ ابْنَ مَرْيَمَ ۗ وَمَا  
أُمِرُوا إِلَّا لِيَعْبُدُوا إِلَهًا وَاحِدًا ۗ لَّا إِلَهَ  
إِلَّا هُوَ ۗ سُبْحٰنَهُ عَمَّا يُشْرِكُونَ ﴿٣١﴾

يُرِيدُونَ أَن يُطْفِئُوا نَوْرَ اللَّهِ بِأَفْوَاهِهِمْ  
وَيَأْبَى اللَّهُ ۗ إِلَّا أَن يُتَمَّ نَوْرُهُ وَلَوْ كَرِهَ  
الْكَافِرُونَ ﴿٣٢﴾

هُوَ الَّذِي أَرْسَلَ رَسُولَهُ بِالْهُدَىٰ وَدِينِ  
الْحَقِّ لِيُظْهِرَهُ عَلَى الدِّينِ كُلِّهِ ۗ وَلَوْ كَرِهَ  
الْمُشْرِكُونَ ﴿٣٣﴾

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِن كَثِيرًا مِّنَ الْأَجْبَارِ  
وَالرُّهْبَانِ لِيَأْكُلُوا أَمْوَالِ النَّاسِ  
بِالْبَاطِلِ وَيُصَدِّدُونَ عَن سَبِيلِ اللَّهِ ۗ

النَّصَارَى

17. Lexoni 61:10.

e Allahut. Ata që grumbullojnë arin dhe argjendin dhe nuk i shpenzojnë në rrugën e Allahut, jepu lajmin e një ndëshkimi të dhimbshëm.

35. Ditën kur do të ndizet fort zjarri i xhehenemit mbi to (mbi arin dhe argjendin), do t'u damkosen balli, ijët dhe shpinat e tyre: "Kjo është ajo që grumbulluat për veten tuaj, andaj, shijojeni atë që keni grumbulluar!"

36. Sigurisht, numri i muajve tek Allahu, në Librin e Allahut, është dymbëdhjetë muaj, që kur i krijoi Ai qiejt e tokën, (dhe) prej tyre katër janë të shenjtë. Kjo është feja e qëndrueshme. Andaj, mos i bëni keq vetes suaj gjatë këtyre muajve. Dhe ju bashkërisht luftoni me idhujtarët, ashtu siç ata bashkërisht luftojnë me ju. Dijeni se Allahu është me ata që kanë drojë (ndaj Allahut).<sup>18</sup>

37. Pa dyshim, *nesija*<sup>19</sup> është një shtesë në mohim. Përmes saj devijojnë ata që mohuan. Ndonjë vit e cilësojnë të lejuar e ndonjë vit e cilësojnë të ndaluar, që ta përmbushin numrin e asaj që Allahu e cilësoi të ndaluar (të paprekshme). Kështu që, ata e cilësojnë të lejuar atë që Allahu e cilësoi të ndaluar (të paprekshme). U duket e bukur ligësia e veprave të tyre. Allahu nuk udhëzon popullin mohues.

18. Lexoni 9:5.

19. Fjala "*nesija*" i referohet një zakoni para Islamit, ku arabët i ndërronin muajt e shenjtë sipas dëshirës së tyre, në mënyrë që të bënin veprime që ishin të ndaluara gjatë atyre muajve, si për shembull lufta etj., dhe disa muaj të tjerë i shpallnin të shenjtë.

وَالَّذِينَ يَكْتُمُونَ الذَّهَبَ وَالنِّصَّةَ وَلَا يُنْفِقُونَهَا فِي سَبِيلِ اللَّهِ لَا نَبَأَ لَهُمْ إِلَّا فِي عَذَابٍ  
الْيَوْمِ ۝٣٥

يَوْمَ يُحَىٰ عَلَيْهَا فِي نَارِ جَهَنَّمَ فَتُكْوَىٰ بِهَا  
جِبَاهُهُمْ وَجُنُوبُهُمْ وَأُخْرَاهُمْ ۗ هَذَا مَا  
كُنْتُمْ لِأَنفُسِكُمْ فَذَوْقُوا مَا كُنْتُمْ  
تَكْتُمُونَ ۝٣٥

إِنَّ عِدَّةَ الشُّهُورِ عِنْدَ اللَّهِ اثْنَا عَشَرَ شَهْرًا  
فِي كِتَابِ اللَّهِ يَوْمَ خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ  
مِنْهَا أَرْبَعَةٌ حَرَمٌ ۗ ذَلِكَ الدِّينُ الْقَيِّمُ ۗ  
فَلَا تَظْلِمُوا فِيهِنَّ أَنفُسَكُمْ وَقَاتِلُوا  
الْمُشْرِكِينَ كَافَّةً كَمَا يُقَاتِلُونَكُمْ كَافَّةً ۗ  
وَاعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ مَعَ الْمُتَّقِينَ ۝٣٦

إِنَّمَا النَّسِيءُ زِيَادَةٌ فِي الْكُفْرِ يُضَلُّ بِه  
الَّذِينَ كَفَرُوا يُحِلُّونَهُ عَامًا وَيُحَرِّمُونَهُ  
عَامًا لِيُوَاطِّئُوا عِدَّةَ مَا حَرَّمَ اللَّهُ فَيُحِلُّوا  
مَا حَرَّمَ اللَّهُ ۗ زَيْنَ لَهُمْ سُوءَ أَعْمَالِهِمْ  
۝٣٧ وَاللَّهُ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الْكَافِرِينَ ۝٣٨

38. O ju që besuat! Çfarë ju ndodh që kur ju thuhet të dilni në rrugën e Allahut (për luftë), ju kërruseni si të rënduar pas toke? A keni pëlqyer jetën e kësaj bote në vend të *ahiretit*? Atëherë në *ahiret* përfitimi i kësaj bote nuk do të mbetet përveçse shumë pak.

39. Nëse nuk dilni (për luftë), Ai do t'ju dënojë me ndëshkim të dhimbshëm dhe do t'ju zëvendësojë me një popull tjetër, ndërsa ju aspak nuk mund ta dëmtoni Atë. Allahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë.

40. Nëse ju nuk ndihmoni atë (pra, të Dërguarin), Allahu (vetëm) e ka ndihmuar atë (edhe më parë), kur atë e dëbuan mohuesit, kur ai ishte njëri prej të dyve, kur ata të dy ishin në shpellë, kur ai i thoshte shokut të vet: “Mos u brengos, Allahu është me ne”. Pra, Allahu zbriti qetësinë e Tij mbi të, e ndihmoi me një ushtri që nuk e keni parë, kurse fjalën e atyre që mohuan e çoi poshtë. Fjala e Allahut është ajo që është më e larta dhe Allahu është i Plotfuqishëm, i Urtë.<sup>20</sup>

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا مَا لَكُمْ إِذَا قِيلَ لَكُمْ انْفِرُوا فِي سَبِيلِ اللَّهِ أَتَأْتَلْتُمْ إِلَى الْأَرْضِ أَرْضَيْتُمْ بِالْحَيَاةِ الدُّنْيَا مِنَ الْآخِرَةِ فَمَا مَتَاعَ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا فِي الْآخِرَةِ إِلَّا قَلِيلٌ ﴿٣٨﴾

إِلَّا تَتَفَرُّوا يُعَذِّبُكُمْ عَذَابًا أَلِيمًا ۖ وَيَسْتَبْدِلْ قَوْمًا غَيْرَكُمْ وَلَا تَضُرُّوهُ شَيْئًا ۗ وَاللَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿٣٩﴾

إِلَّا تَتَضَرَّوهُ فَقَدْ نَصَرَهُ اللَّهُ إِذْ أَخْرَجَهُ الَّذِينَ كَفَرُوا ثَانِيَ اثْنَيْنِ إِذْ هُمَا فِي الْغَارِ إِذْ يَقُولُ لِصَاحِبِهِ لَا تَحْزَنْ إِنَّ اللَّهَ مَعَنَا ۗ فَأَنْزَلَ اللَّهُ سَكِينَتَهُ عَلَيْهِ وَأَيَّدَهُ بِجُنُودٍ لَّمْ تَرَوْهَا وَجَعَلَ كَلِمَةَ الَّذِينَ كَفَرُوا السُّفْلَىٰ ۗ وَكَلِمَةُ اللَّهِ هِيَ الْعُلْيَا ۗ وَاللَّهُ عَزِيزٌ حَكِيمٌ ﴿٤٠﴾

20. Ajeti flet për ngjarjen e mërgimit (hixhreti) të Profetit të Shenjtë<sup>savs</sup> nga Meka në Medine, i shoqëruar nga Ebu Bekri<sup>ra</sup>. Ata u strehuan në një shpellë të quajtur Theur. Ndër të tjera, ajeti hedh dritë edhe mbi statusin shumë të lartë shpirtëror të Ebu Bekri<sup>ra</sup>, i cili përmendet si *shoku i tij*, dhe gjithashtu si një ndër *dy veta* me të cilët ishte Allahu. Përveç kësaj, në këtë ajet vërejmë edhe një përjasje interesante. Gjatë këtij momenti kritik, i Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> tha – Allahu është me ne! Pra, jo vetëm me të Dërguarin e Allahut, por edhe me *Hazret Ebu Bekri<sup>ra</sup>*, i cili përfaqësonte gjithë xhematin e besimtarëve. Në një moment të ngjashëm si ky, kur shokët e *Hazret Musait<sup>as</sup>* e panë ushtrinë e Faraonit që po i ndiqte, thanë – Na zunë përnjëmend!, *Hazret Musai<sup>as</sup>* iu përgjigj – Kurrsesi! E kam Zotin tim me mua! (26:63). Ndryshe nga Profeti Muhammed<sup>savs</sup>, *Hazret Musai<sup>as</sup>* tregoi shoqërimin e Zotit vetëm me veten e tij. Bijtë e Izraelit vazhdimisht grindeshin me *Hazret Musain<sup>as</sup>*, ankoheshin për vështirësitë që hasnin në rrugën e Zotit dhe e kritikonin ashpër. Andaj, Allahu e bëri *Hazret Musain<sup>as</sup>* ta shprehte shoqërimin



41. Dilni të lehtë dhe të rëndë dhe luftoni në rrugën e Allahut me pasuritë tuaja dhe me jetën tuaj. Kjo është më e mirë për ju, në qoftë se dini.

انْفِرُوا خِفَافًا وَثِقَالًا وَ جَاهِدُوا  
بِأَمْوَالِكُمْ وَأَنْفُسِكُمْ فِي سَبِيلِ اللَّهِ ذِكْرُكُمْ  
خَيْرٌ لَّكُمْ إِنْ كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ ①

42. Po të kishte një tokë të afërt dhe udhëtim të lehtë, do të të ndiqnin ty, por mundimi iu duk i vështirë. Ata me siguri do të betohen për Allahun: “Po të kishim mundësi, patjetër do të dilnim së bashku me ju”. Po e shkatërrojnë veten e tyre. Dhe Allahu e di që ata janë gënjeshtarë.

لَوْ كَانَ عَرَصًا قَرِيبًا وَ سَفَرًا قَاصِدًا  
لَاتَّبَعُوكَ وَلَكِنْ بَعَدَتْ عَلَيْهِمُ السُّفُفَةُ  
وَ سَيَحْلِفُونَ بِاللَّهِ لَوِ اسْتَطَعْنَا لَخَرَجْنَا  
مَعَكُمْ ۚ يَهْلِكُونَ أَنْفُسَهُمْ ۗ وَاللَّهُ يَعْلَمُ  
إِنَّهُمْ لَكَاذِبُونَ ②

43. Allahu të faltë!<sup>21</sup> Pse i lejove përpara se të bëhej e qartë se cilët thanë të vërtetën e t'i dije edhe ata që janë gënjeshtarë?!

عَفَا اللَّهُ عَنْكَ ۚ لِمَ أَذِنْتَ لَهُمْ حَتَّىٰ يَتَّبِعِنَ  
لَكَ الَّذِينَ صَدَقُوا وَ تَعْلَمَ الْكَاذِبِينَ ③

44. Nuk të kërkojnë leje për të mos luftuar me pasuritë dhe jetën e tyre ata që e besojnë Allahun dhe Ditën e *Ahiretit*. Dhe Allahu është i Gjithëdijshëm për ata që kanë drojë (Allahun).

لَا يَسْتَأْذِنُكَ الَّذِينَ يُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ  
الْآخِرِ أَنْ يُجَاهِدُوا بِأَمْوَالِهِمْ وَأَنْفُسِهِمْ  
وَ اللّٰهُ عَلِيمٌ بِالْمُتَّقِينَ ④

45. Të kërkojnë leje vetëm ata që nuk besojnë Allahun dhe Ditën e *Ahiretit*. Zemrat e tyre dyshojnë. Ndaj, ata luhaten në mëdyshtjen e vet.

إِنَّمَا يَسْتَأْذِنُكَ الَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ  
وَالْيَوْمِ الْآخِرِ وَارْتَابَتْ قُلُوبُهُمْ فَهُمْ فِي  
رَبِّهِمْ يَتَرَدَّدُونَ ⑤

46. Po të donin të dilnin (për xhihad), do të bënin ndonjë përgatitje për të, por Allahu nuk e pëlqeu ngritjen e

وَ لَوْ أَرَادُوا الْخُرُوجَ لَأَعَدُّوا لَهُ عُدَّةً  
وَ لَكِنَّ كَرِهَ اللَّهُ انْبِعَاثَهُمْ فَثَبَّطَهُمْ

e Tij vetëm me të. Kjo tregon epërsinë e Profetit Muhammed<sup>savs</sup> dhe lartësinë e tij shpirtërore.

21. Shprehja arabe *'afallahu 'anke* (Allahu të faltë!) nuk nënkupton faljen e mëkatit, që të nxirret më pas përfundimi se Profeti<sup>savs</sup> të kishte kryer ndonjë mëkat, *ma'adhallah!* Përkundrazi, kjo frazë shpreh dashurinë dhe përkujdesjen Hyjnore për të.

tyre (për këtë kauzë të madhe), ndaj, i la poshtë, dhe atyre iu tha: “Rrini me të mbeturit!”

47. Po të dilnin bashkë me ju, do t’ju shtonin vetëm çorganizim, do të rendnin kafshët midis jush duke dashur ngatërrësë me ju. Dhe mes jush ka edhe të tillë që i dëgjojnë me vëmendje. Allahu është i Gjithëdijshëm për mizorët.

48. Ata kanë dashur (ta krijonin) ngatërrësën edhe më parë dhe t’i pështjelluan ty çështjet, derisa erdhi e vërteta dhe doli vendimi i Allahut, ndonëse ata e urrenin.

49. Prej tyre ka edhe të tillë që thonë: “Më jep leje dhe mos më fut në ngatërrësë”. Kujdes! Ata tashmë ranë në ngatërrësë dhe sigurisht, xhehenemi do t’i rrethojë mohuesit.

50. Kur të vjen ndonjë e mirë, ajo i lëndon dhe kur të vjen ndonjë vështirësi, thonë: “Ne e morëm çështjen tonë (në dorë) që përpara”, dhe ikin të gëzuar, duke e kthyer shpinën.

51. Thuaju: Kurrsesi nuk do të na vijë ndonjë vështirësi, përveç asaj që Allahu ka shkruar për ne. Ai është Miku ynë. Dhe vetëm Allahut le t’i mbështeten besimtarët.

52. Thuaju: A mund të prisni për ne diçka tjetër përveçse njërën prej dy të mirave?! Kurse për ju ne presim që

وَقِيلَ افْعَدُوا مَعَ الْفَعْدِيِّينَ ﴿٤٧﴾

لَوْ خَرَجُوا فِيكُمْ مَا زَادُوكُمْ إِلَّا خَبَالًا  
وَلَا أَوْضَعُوا خِلَالَكُمْ يَبْغُونَكُمُ الْفِتْنَةَ  
وَفِيكُمْ سَمْعُونُ لَهُمْ وَاللَّهُ عَلِيمٌ  
بِالظَّالِمِينَ ﴿٤٨﴾

لَقَدْ ابْتَعُوا الْفِتْنَةَ مِنْ قَبْلُ وَقَلَّبُوا لَكَ  
الْأُمُورَ حَتَّىٰ جَاءَ الْحَقُّ وَظَهَرَ أَمْرُ اللَّهِ  
وَهُمْ كَرِهُونَ ﴿٤٩﴾

وَمِنْهُمْ مَن يَقُولُ انذَنْ لِي وَلَا تَفْتِنِّي  
إِلَّا فِي الْفِتْنَةِ سَقَطُوا وَإِنَّ جَهَنَّمَ  
لَمَحِيظَةٌ بِالْكَافِرِينَ ﴿٥٠﴾

إِنْ تُصِيبَكَ حَسَنَةٌ تَسُؤْهُمْ وَإِنْ تُصِيبَكَ  
مُصِيبَةٌ يَقُولُوا قَدْ أَخَذْنَا أَمْرَنَا مِنْ قَبْلُ  
وَيَتَوَلَّوْا وَهُمْ فَرِحُونَ ﴿٥١﴾

قُلْ لَنْ يُصِيبَنَا إِلَّا مَا كَتَبَ اللَّهُ لَنَا  
هُوَ مَوْلَانَا وَعَلَى اللَّهِ فَلْيَتَوَكَّلِ  
الْمُؤْمِنُونَ ﴿٥٢﴾

قُلْ هَلْ تَرَبَّصُونَ بِنَا إِلَّا إِحْدَى  
الْحُسَيْنَيْنِ ۖ وَنَحْنُ نَتَرَبَّصُ بِكُمْ أَنْ

Allahu t'ju godasë me ndëshkim prej Vetes ose prej duarve tona. Kështu që, prisni, edhe ne me ju po presim.

53. Thuaju: Shpenzoni qoftë me dëshirë, qoftë me mosdëshirë, kurrsesi nuk do t'ju pranohet. Sigurisht, jeni njerëz të ligj.

54. Dhe atyre u është mohuar që t'u pranohen pasuritë, vetëm sepse ata e mohuan Allahun dhe të Dërguarin e Tij, dhe nuk i afrohen namazit përveçse përtacë dhe nuk shpenzojnë përveçse me mosdëshirë.

55. Ndaj, nuk duhet të të tërheqin ty as pasuritë e tyre e as pasardhësit e tyre. Vërtet, Allahu dëshiron t'i ndëshkojë ata përmes tyre në jetën e kësaj bote dhe t'ua marrë shpirtat kur ata të jenë mohues.

56. Dhe betohen për Allahun se ata përnjëmend janë prej jush, por nuk janë prej jush. Në të vërtetë, ata janë një popull frikacak.

57. Po të gjejnë ndonjë strehë, shpellë ose hyrje (për t'u fshehur), do të turren drejt saj.

58. Dhe ka edhe të tillë prej tyre që të akuzojnë ty në lidhje me lëmoshat. Pra, kur u jepet prej tyre, gëzohen, e kur nuk u jepet prej tyre, hidhërohen.

59. Sikur të gëzoheshin nga ajo që u dha Allahu dhe i Dërguari i Tij e të thoshin: "Na mjafton Allahu; Allahu

يُصِيبُكُمْ اللَّهُ بِعَذَابٍ مِّنْ عِنْدِهِ أَوْ  
بِأَيْدِينَا ۖ فَتَرَبَّصُوا إِنَّا مَعَكُمْ مُتِرِبِصُونَ ﴿٥٧﴾

قُلْ أَنْفِقُوا طَوْعًا أَوْ كَرْهًا لَّنْ يَتَّخَبَلَ  
مِنْكُمْ ۗ إِنَّكُمْ كُنْتُمْ قَوْمًا فَسِيقِينَ ﴿٥٨﴾

وَمَا مَنَعَهُمْ أَنْ تُقْبَلَ مِنْهُمْ نَفَقَتُهُمْ إِلَّا  
أَنَّهُمْ كَفَرُوا بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ وَلَا يَأْتُونَ  
الصَّلَاةَ إِلَّا وَهُمْ كَسَالَىٰ وَلَا يُنْفِقُونَ إِلَّا  
وَهُمْ كَرِهُونَ ﴿٥٩﴾

فَلَا تُحِبُّكَ أَمْوَالُهُمْ وَلَا أَوْلَادُهُمْ ۗ إِنَّمَا  
يُرِيدُ اللَّهُ لِيُعَذِّبَهُمْ بِهَا فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا  
وَيَزَهَّقَ أَنْفُسَهُمْ وَهُمْ كَافِرُونَ ﴿٦٠﴾

وَيَخْلِفُونَ بِاللَّهِ إِنَّهُمْ لَمِنْكُمْ ۗ وَمَا هُمْ  
مِنْكُمْ وَلَكِنَّهُمْ قَوْمٌ يَّفْرُقُونَ ﴿٦١﴾

لَوْ يَجِدُونَ مَلْجَأًا أَوْ مَغْرَبًا أَوْ مَدْخَلًا  
لَّوَلَّوْا إِلَيْهِ وَهُمْ يَجْمَحُونَ ﴿٦٢﴾

وَمِنْهُمْ مَّنْ يَّالِمُكَ فِي الصَّدَقَاتِ ۗ فَإِنْ  
أَعْطُوا مِنْهَا رِضْوَانًا وَإِنْ لَّمْ يُعْطُوا مِنْهَا  
إِذَا هُمْ يَسْخَطُونَ ﴿٦٣﴾

وَلَوْ أَنَّهُمْ رَضُوا مَا آتَاهُمُ اللَّهُ وَرَسُولُهُ  
وَقَالُوا حَسْبُنَا اللَّهُ سَيُؤْتِينَا اللَّهُ مِنْ

patjetër do të na japë (shumë gjëra) prej bekimit të Tij dhe i Dërguari i Tij gjithashtu; ne pa dyshim tek Allahu shpresojmë”!

60. Në të vërtetë, lëmoshat<sup>22</sup> janë për të varfrit, nevojtarët, për ata që punojnë për to, për të fituar zemrat, për lirim e të robëruarve, për të rënduarit me borxhe, (për shpenzime) në rrugën e Allahut dhe për udhëtarët. Është detyrim prej Allahut. Dhe Allahu është i Gjithëdijshëm, i Urtë.

61. Dhe ka edhe të tillë prej tyre, të cilët e lëndojnë Profetin dhe thonë: “Ky qenka vetëm vesh!” Thuaju: Po, është vesh vetëm se për dobinë tuaj; e beson Allahun, u beson besimtarëve dhe është mëshirë për ata që besuan mes jush. Dhe ata që e lëndojnë të Dërguarin e Allahut, do të kenë ndëshkim të dhimbshëm.

62. Ata betohen për Allahun përpara jush që t’ju kënaqin ju, kurse Allahu dhe i Dërguari i Tij ishin më të denjë që ata t’i kënaqin, po të ishin besimtarë.

63. A nuk e dinë se për atë që armiqësohet me Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ka zjarrin e xhehenemit, në të cilin ai do të mbesë gjatë?! Ky është poshtërim shumë i madh.

﴿ فَضْلِهِ وَرَسُولُهُ إِنَّا إِلَى اللَّهِ رَاغِبُونَ ﴾

إِنَّمَا الصَّدَقَاتُ لِلْفُقَرَاءِ وَالْمَسْكِينِ  
وَالْعَمِلِينَ عَلَيْهَا وَالْمُؤَلَّفَةِ قُلُوبُهُمْ وَفِي  
الرِّقَابِ وَالْغُرَمِيِّنَ وَفِي سَبِيلِ اللَّهِ وَابْنِ  
السَّبِيلِ ۗ فَرِيضَةً مِّنَ اللَّهِ ۗ وَاللَّهُ عَلِيمٌ  
حَكِيمٌ ﴿٦٠﴾

وَمِنْهُمْ الَّذِينَ يُؤَدُّونَ النَّبِيَّ وَيَقُولُونَ  
هُوَ آذَنٌ ۗ قُلْ أَدُنُّ حَيْرٌ لَّكُمْ يَوْمَ مِّنَ اللَّهِ  
وَيَوْمَ مِّنَ الْمُؤْمِنِينَ وَرَحْمَةٌ لِّلَّذِينَ آمَنُوا  
مِنْكُمْ ۗ وَالَّذِينَ يُؤَدُّونَ رَسُولَ اللَّهِ لَهُمْ  
عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿٦١﴾

يَخْلِفُونَ بِاللَّهِ لَكُمْ لِيَرْضَوْكُمْ ۚ وَاللَّهُ  
وَرَسُولُهُ أَحَقُّ أَنْ يُرْضَوْهُ إِنْ كَانُوا  
مُؤْمِنِينَ ﴿٦٢﴾

أَلَمْ يَعْلَمُوا أَنَّهُ مَن يُحَادِدِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ  
فَأَنَّ لَهُ نَارَ جَهَنَّمَ خَالِدًا فِيهَا ۗ ذَلِكَ  
الْخِزْيُ الْعَظِيمُ ﴿٦٣﴾

22. “Lëmoshat” (arab. *sadakāt*) në këtë ajet nënkuptojnë “lëmoshat” e detyrueshme, pra zekatin. Ajeti tregon qëllimet dhe njerëzit për të cilët duhet të shpenzohet zekati.

64. Hipokritët frikësohen të zbresë ndonjë sure kundër tyre që ua shfaq atë që kanë zemrat e tyre. Thuaju: Talluni! Sigurisht, Allahu do ta nxjerrë atë që ju frikëson.

يَحْذَرُ الْمُنْفِقُونَ أَنْ تَنْزَلَ عَلَيْهِمْ  
سُورَةٌ تُنَبِّئُهُمْ بِمَا فِي قُلُوبِهِمْ ۗ قُلْ  
اسْتَهْزِئُوا ۗ إِنَّ اللَّهَ مُخْرِجٌ مَّا  
تَحْذَرُونَ ﴿١٤﴾

65. E nëse i pyet, patjetër do të thonë: “Ne thjesht po bënim shaka dhe po luanim.” Thuaju: A po talleshit me Allahun, me shenjat e Tij dhe me të Dërguarin e Tij?!

وَلَيْنِ سَأَلْتَهُمْ لَيَقُولُنَّ إِنَّمَا كُنَّا نَخُوضُ  
وَنُلْعَبُ ۗ قُلْ أَبِاللَّهِ وَآيَاتِهِ وَرَسُولِهِ  
كُنْتُمْ تَسْتَهْزِئُونَ ﴿١٥﴾

66. Mos u shfajësoni! Tashmë keni mohuar, pasi e pranuat besimin. Ne nëse falim ndonjë grup prej jush, (mund të) ndëshkojmë ndonjë grup (tjetër), sepse janë fajtorë.

لَا تَعْتَدُوا ۗ قَدْ كَفَرْتُمْ بَعْدَ إِيمَانِكُمْ ۗ  
إِنْ تَعْفُ عَنْ طَآئِفَةٍ مِّنْكُمْ نُعَذِّبُ  
طَآئِفَةً يَّآلَهُمْ كَانُوا مُجْرِمِينَ ﴿١٦﴾

67. Hipokritët dhe hipokritet janë për njëri-tjetrin. Urdhërojnë të keqen, ndalojnë nga e mira dhe dorën e mbajnë të shtrënguar (nga të shpenzuarit në rrugën e Allahut). Ata e harruan Allahun, ndaj, Ai i harroi ata. Pikërisht hipokritët janë të ligj.

الْمُنْفِقُونَ وَالْمُنْفِقَاتُ بِعُضُوبٍ مِّنْ بَعْضِ  
يَأْمُرُونَ بِالْمَسْكِرِ وَيَهْوُونَ عَنِ الْمَعْرُوفِ  
وَيَقْبِضُونَ أَيْدِيَهُمْ ۗ نَسُوا اللَّهَ فَنَسِيَهُمْ  
إِنَّ الْمُنْفِقِينَ هُمُ الْفٰسِقُونَ ﴿١٧﴾

68. Allahu u premtoi hipokritëve, hipokriteve dhe mohuesve zjarrin e xhehenemit, ku ata do të mbesin gjatë; ai u mjafton. Allahu i mallkoi, dhe ata do të kenë ndëshkim të qëndrueshëm.

وَعَدَ اللَّهُ الْمُنْفِقِينَ وَالْمُنْفِقَاتِ وَالْكُفَّارَ  
نَارَ جَهَنَّمَ خَالِدِينَ فِيهَا ۗ هِيَ حَسْبُهُمْ  
وَلَعَنَهُمُ اللَّهُ ۗ وَلَهُمْ عَذَابٌ مُّقِيمٌ ﴿١٨﴾

69. Sikundër ata që ishin para jush; ishin më të fuqishëm se ju dhe kanë pasur më shumë pasuri dhe fëmijë. Ata përfituan sa deshën nga fati i tyre. Edhe ju përfituat sa deshët nga fati juaj, ashtu siç përfituan nga fati

كَأَلَدَيْنَ مِنْ قَبْلِكُمْ كَانُوا أَشَدَّ مِنْكُمْ قُوَّةً  
وَآكْثَرَ أَمْوَالًا وَ أَوْلَادًا ۗ فَاسْتَمْتَعُوا  
بِخَلَاقِهِمْ فَاسْتَمْتَعْتُمْ بِخَلَاقِكُمْ كَمَا  
اسْتَمْتَعَ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِكُمْ بِخَلَاقِهِمْ

i tyre ata që ishin para jush. Edhe ju u morët me biseda të kota, ashtu siç ata u morën me biseda të kota. Të këtillëve u dështuan veprat në këtë botë dhe në *ahiret*, dhe pikërisht këta janë humbës.

70. A nuk u erdhi lajmi i atyre që ishin para tyre: (pra, lajmi) i popullit të Nuhut, i adëve, i themudëve, i popullit të Ibrahimit, i banorëve të Medjenit dhe i fshatrave që u rrokullisën?! Atyre u erdhën të Dërguarit e tyre me shenjat e qarta. Kështu që, nuk është Allahu që u bëri padrejtësi, por ishin vetë ata që i bënë padrejtësi vetvetes.

71. Dhe besimtarët dhe besimtare të tjerë janë miq të njëri-tjetrit. Ata urdhërojnë të mirën, ndalojnë nga e keqja, falin namazin, japin zekatin dhe i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Pikërisht këta janë që Allahu do t'i mëshirojë. Sigurisht, Allahu është i Plotfuqishëm, i Urtë.

72. Allahu u premtoi besimtarëve dhe besimtareve kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj, ku ata do të jetojnë përgjithmonë, dhe shtëpi të pastra që do të jenë në kopshte të përhershme, dhe pëlqimi i Allahut është më i madhi. Ky pikërisht është suksesi madhështor.<sup>23</sup>

وَحُضِّتُمْ كَالَّذِي خَاصُوا أَوْلِيَّكَ  
حِطَّتْ أَعْمَالُهُمْ فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ  
وَأَوْلِيَّكَ هُمُ الْخَاسِرُونَ ﴿٦٩﴾

أَلَمْ يَأْتِهِمْ نَبَأُ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ قَوْمُ  
نُوحٍ وَ عَادٍ وَ ثَمُودَ وَ قَوْمِ إِبْرَاهِيمَ  
وَ أَصْحَابِ مَدْيَنَ وَ الْمَوْتَفَكِّتِ أَتَتْهُمْ  
رُسُلُهُمْ بِالْبَيِّنَاتِ فَمَا كَانَ اللَّهُ  
لِيُظْلِمَهُمْ وَلَكِنْ كَانُوا أَنْفُسَهُمْ  
يُظْلِمُونَ ﴿٧٠﴾

وَالْمُؤْمِنُونَ وَالْمُؤْمِنَاتُ بَعْضُهُمْ أَوْلِيَاءُ  
بَعْضٍ يُأْمُرُونَ بِالْمَعْرُوفِ وَيَنْهَوْنَ عَنِ  
الْمُنْكَرِ وَ يُقِيمُونَ الصَّلَاةَ وَ يُؤْتُونَ  
الزَّكَاةَ وَ يُطِيعُونَ اللَّهَ وَ رَسُولَهُ أَوْلِيَّكَ  
سَيَرْحَمُهُمُ اللَّهُ إِنَّ اللَّهَ عَزِيزٌ  
حَكِيمٌ ﴿٧١﴾

وَعَدَ اللَّهُ الْمُؤْمِنِينَ وَالْمُؤْمِنَاتِ جَنَّاتٍ  
تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا  
وَ مَسْكِنٍ طَيِّبَةٍ فِي جَنَّاتٍ عَدْنٍ وَ رِضْوَانٍ  
مِّنَ اللَّهِ أَكْبَرَ ذَلِكَ هُوَ الْفَوْزُ  
بِالْعَظِيمِ ﴿٧٢﴾

23. Kënaqësia më e madhe e besimtarit qëndron në Zotin e Madhërishtëm, përtej të cilit nuk ka kënaqësi a lumturi tjetër. "Xhenet" fjalë për fjalë do të thotë diçka e fshehtë dhe xhenetit i thonë *xhenet* për shkak se ai është i mbuluar me bekime të shumta të Zotit. Por xheneti i vërtetë është Vetë Zoti, që është Burimi i lumturisë dhe me të cilin njeriu nuk mund të ketë

73. O Profet! Lufto kundër mohuesve dhe hipokritëve dhe shtrëngoji ata.<sup>24</sup> Vendi i tyre është xhehenemi. Sa destinacion i keq është ai!

74. Ata betohen për Allahun që nuk e thanë fjalën e mohimit, kurse ata e thanë dhe mohuan pasi e pranuan Islamin. Ishin të vendosur për diçka që s'arritën. Ata u inatosën (me besimtarët) vetëm sepse Allahu dhe i Dërguari i Tij i pasuruan me bekimin e Tij. Ndaj, nëse pendohen, do të jetë mirë për ta e nëse e kthejnë shpinën, do t'i dënojë Allahu me ndëshkim të dhimbshëm në këtë botë dhe në *ahiret*, dhe ata nuk do të kenë në tokë as mik e as ndihmës.

75. Dhe ka edhe të tillë prej tyre që i premtuan Allahut: “Po të na japë Ai diçka prej bekimit të Tij, ne patjetër do të japim lëmoshë dhe do të bëhemi ndër të dëlirët”.

76. E kur Ai u dha diçka prej bekimit të Tij, u treguan koprracë me të, ia kthyen shpinën (premtimit) dhe ishin shpërfillës.

يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ جَاهِدِ الْكُفَّارَ وَالْمُنَافِقِينَ  
وَأَغْلُظْ عَلَيْهِمْ ۗ وَمَا لَهُمْ جَهَنَّمَ  
وَيْسَ الْمَصِيرُ ﴿٧٣﴾

يَحْلِفُونَ بِاللَّهِ مَا قَالُوا ۗ وَلَقَدْ قَالُوا كَلِمَةَ  
الْكُفْرِ وَكَفَرُوا بَعْدَ إِسْلَامِهِمْ وَهُمْ  
بِمَالِهِمْ يَنَالُونَ ۗ وَمَا نَقَمُوا إِلَّا أَنْ أَغْنَاهُمُ  
اللَّهُ وَرَسُولُهُ مِنْ فَضْلِهِ ۗ فَإِنْ يَتُوبُوا يَكُ  
خَيْرًا لَّهُمْ ۗ وَإِنْ يَتَوَلَّوْا يُعَذِّبُهُمُ اللَّهُ  
عَذَابًا أَلِيمًا ۗ فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ ۗ وَمَا لَهُمْ  
فِي الْأَرْضِ مِنْ وَلِيٍّ وَلَا نَصِيرٍ ﴿٧٤﴾

وَمِنْهُمْ مَّنْ عٰهَدَ اللّٰهَ لَئِن اٰتٰنَا  
مِنْ فَضْلِهِ لَنَصَّدَّقَنَّ وَلَنَكُوْنَنَّ مِنَ  
الصّٰلِحِيْنَ ﴿٧٥﴾

فَلَمَّا اٰتٰهُمْ مِنْ فَضْلِهِ بَخِلُوْا بِهٖ وَتَوَلَّوْا  
وَهُمْ مُّعْرِضُوْنَ ﴿٧٦﴾

asnjë brengë a vuajtje. Për këtë arsye, pasi përshkruhen bekimet e xhenetit, ky ajet pohon: “pëlqimi i Allahut është më i madhi”. Njeriu në raport me njeriun tjetër gjithmonë është i përfshirë në brenga, kurse me Zotin, sa më shumë që i afrohet Atij, aq më shumë vishet me ngjyra Hyjnore, dhe po kështu, aq më shumë gëzon qetësi dhe lumturi. Edhe Profeti<sup>savs</sup> tha: “Pajisuni me moralet e Allahut!” (Sujuti, Te’jüd, 83) Pra, sa më shumë ta kesh afrimin me Zotin, aq më shumë do të marrësh pjesë edhe në bekimet e Tij.

24. Xhihad (paskajorja nga folja *xhede*) do të thotë, ai u përpoq fort për një qëllim të caktuar, përgjithësisht në këtë kuptim është përdorur kjo fjalë në Kuran. Nuk përmendet në Kuran se si duhet të luftonte Profeti<sup>savs</sup> kundër hipokritëve. Andaj, edhe këtu nuk ka asgjë që tregon të luftuarit me armë. Në fakt, Profeti i Shenjtë<sup>savs</sup> nuk ka bërë kurrë luftë kundër hipokritëve. Lexoni edhe 66:10; 25:33.

77. Ai u la atyre si pasojë hipokrizinë në zemrat e tyre deri në ditën kur do ta takojnë Atë, për shkak se i shkelën Allahut premtimin që kishin bërë dhe për shkak se gënjenin.

فَاعْتَبَهُمْ نِفَاقًا فِي قُلُوبِهِمْ إِلَى يَوْمِ يَلْقَوْنَهُ بِمَا أَخْلَفُوا اللَّهَ مَا وَعَدُوهُ وَبِمَا كَانُوا يَكْذِبُونَ ﴿٧٧﴾

78. A nuk e dinë se Allahu me siguri ua di sekretet dhe pëshpëritjet dhe se Allahu me siguri është Dijeploiti i të fshehtave?!

أَلَمْ يَعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ يَعْلَمُ سِرَّهُمْ وَنَجْوَاهُمْ وَأَنَّ اللَّهَ عَلَّامُ الْغُيُوبِ ﴿٧٨﴾

79. Ata që i akuzojnë vullnetarët prej besimtarëve në lidhje me lëmoshat si dhe (i akuzojnë) ata që nuk kanë asgjë tjetër përveç përpjekjes së tyre, pra tallen me ta; Allahu do të tallet me ta<sup>25</sup> dhe ata do të kenë ndëshkim të dhimbshëm.

الَّذِينَ يَلْمِزُونَ الْمُطَّوِّعِينَ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ فِي الصَّدَقَاتِ وَالَّذِينَ لَا يَجِدُونَ إِلَّا جُهْدَهُمْ فَيَسْخَرُونَ مِنْهُمْ سَخِرَ اللَّهُ مِنْهُمْ وَلَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿٧٩﴾

80. Kërko falje për ta ose mos kërko falje për ta; edhe sikur të kërkoksh falje shtatëdhjetë herë, Allahu nuk ka për t'i falur. Kjo sepse ata përnjëmend e kanë mohuar Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe Allahu nuk i udhëzon njerëzit e pabindshëm.

اسْتَغْفِرْ لَهُمْ أَوْ لَا تَسْتَغْفِرْ لَهُمْ إِنْ تَسْتَغْفِرْ لَهُمْ سَبْعِينَ مَرَّةً فَلَنْ يَغْفِرَ اللَّهُ لَهُمْ ذَلِكَ بِأَنَّهُمْ كَفَرُوا بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ ﷻ وَاللَّهُ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الْفَاسِقِينَ ﴿٨٠﴾

81. Të mbeturit mbrapa u gëzuan për ndenjjen e tyre prapa të Dërguarit të Allahut dhe nuk pëlqyen të luftonin me pasuritë dhe jetën e tyre në rrugën e Allahut dhe thanë: “Mos u nisni në këtë të nxehtë!” Thuaju: “Zjarri i xhehenemit është akoma më i nxehtë!” Eh, sikur të kuptonin!

فَرِحَ الْمُخَلَّفُونَ بِمَقْعَدِهِمْ خِلَافَ رَسُولِ اللَّهِ وَكَرِهُوا أَنْ يُجَاهِدُوا بِأَمْوَالِهِمْ وَأَنْفُسِهِمْ فِي سَبِيلِ اللَّهِ وَقَالُوا لَا تَنْفِرُوا فِي الْحَرِّ قُلْ نَارُ جَهَنَّمَ أَشَدُّ حَرًّا لَوْ كَانُوا يَفْقَهُونَ ﴿٨١﴾

25. Do të thotë, Allahu do t'i përgjigjet talljes së tyre.



82. Pra, le të qeshin pak e të qajnë shumë, si dënim i asaj që kanë punuar.

83. Ndaj, nëse Allahu të kthen te ndonjë grup prej tyre dhe ata të kërkojnë leje për të dalë (bashkë me ty), thuaju: “Më kurrë mos dilni bashkë me mua dhe kurrë mos luftoni me mua armikun; keni pëlqyer ndenjjen (në shtëpi) herën e parë, ndaj edhe tani rrinin me ata që rrinë (në shtëpi).”

84. Kurrë mos i fal (xhenazen) asnjë të vdekuri prej tyre dhe as mos qëndro pranë varrit të tij (për të bërë *dua* për të). Pa dyshim, ata e mohuan Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe vdiqën të pabindshëm.

85. Le të mos të habitin ty pasuritë dhe fëmijët e tyre. Në të vërtetë, Allahu do që t'i ndëshkojë ata përmes tyre në këtë botë, dhe ata të vdesin mohues.

86. E kur zbret ndonjë sure që (pohon): “Besoni Allahun dhe luftoni bashkë me të Dërguarin e Tij”, pasanikët prej tyre të kërkojnë leje dhe thonë: “Na lërë të jemi me ata që rrinë pas.”

87. Ata pëlqyen të rrinin me gratë që rrinë pas (në shtëpi) dhe u janë vulosur zemrat, ndaj, nuk kuptojnë.

88. Por i Dërguari dhe ata që besuan bashkë me të, luftuan me pasuritë dhe jetët e tyre. Janë pikërisht këta

فَلْيُصْحَكُوا قَلِيلًا وَيَبْكُوا كَثِيرًا  
جَزَاءً بِمَا كَانُوا يَكْسِبُونَ ﴿٧١﴾

فَإِنْ رَجَعَكَ اللَّهُ إِلَى طَائِفَةٍ مِنْهُمْ  
فَأَسْتَأذِنُوكَ لِلخُرُوجِ فَقُلْ لَنْ  
تَخْرُجُوا مَعِيَ أَبَدًا وَلَنْ تُقَاتِلُوا مَعِيَ  
عَدُوًّا ۗ إِنَّكُمْ رَضِيتُمْ بِالْقُعُودِ أَوَّلَ  
مَرَّةٍ فَأَقْعُدُوا مَعَ الْخُلَفَاءِ ﴿٧٢﴾

وَلَا تَصِلْ عَلَى أَحَدٍ مِنْهُمْ مَاتَ أَبَدًا  
وَلَا تَقُمْ عَلَى قَبْرِهِ ۗ إِنَّهُمْ كَفَرُوا بِاللَّهِ  
وَرَسُولِهِ وَمَاتُوا وَهُمْ فَسِقُونَ ﴿٧٣﴾

وَلَا تُعْجِبْكَ أَمْوَالُهُمْ وَأَوْلَادُهُمْ ۗ إِنَّمَا  
يُرِيدُ اللَّهُ أَنْ يُعَذِّبَهُمْ بِهَا فِي الدُّنْيَا  
وَتَرْهَقَ أَنْفُسُهُمْ وَهُمْ كَافِرُونَ ﴿٧٤﴾

وَإِذَا أَنْزَلْتَ سُورَةَ ۗ أَنْ آمَنُوا بِاللَّهِ  
وَجَاهَدُوا مَعَ رَسُولِهِ اسْتَأْذَنَكَ أُولُو  
الطَّلُوبِ مِنْهُمْ وَقَالُوا ذَرْنَا نَكُنْ مَعَ  
الْقَاعِدِينَ ﴿٧٥﴾

رَضُوا بِأَنْ يَكُونُوا مَعَ الْخَوَالِفِ وَطَبَعَ  
عَلَى قُلُوبِهِمْ فَهُمْ لَا يَفْقَهُونَ ﴿٧٦﴾

لَكِنَّ الرُّسُولَ وَالَّذِينَ آمَنُوا مَعَهُ جَاهَدُوا  
بِأَمْوَالِهِمْ وَأَنْفُسِهِمْ ۗ وَأُولَئِكَ لَهُمْ

që do t'i kenë mirësitë dhe janë pikërisht këta që janë të suksesshmit.

89. Allahu ka përgatitur për ta kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Ata në to do të jetojnë përgjithmonë. Ky është sukseksi madhështor.

90. Dhe erdhën hileqarët prej beduinëve që t'u jepet leje (për të qëndruar në shtëpi), dhe ndenjën ata që gënjyen Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Prej tyre ata që mohuan, patjetër do t'i zërë një ndëshkim i dhimbshëm.

91. Nuk ka gjynah për të dobëtit, për të sëmurët dhe për ata që nuk gjejnë asgjë për të shpenzuar, me kusht që të jenë të sinqertë me Allahun dhe (me) të Dërguarin e Tij. Nuk ka arsye për vërejtje për mirëbërësit, dhe Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

92. E as për ata që kur të erdhën që t'i mbartje (për të shkuar në xhihad, dhe) ti u the: "Nuk gjej ndonjë mjet që t'ju mbart", ata u kthyen, ndërkohë që sytë e tyre u lotonin nga brenga që nuk kishin asgjë për të shpenzuar (në rrugën e Zotit).

93. Arsyeja për vërejtje është kundër atyre që të kërkojnë leje edhe pse janë të pasur. Ata pëlqyen të rrinin me gratë që rrinë pas (në shtëpi). Allahu ua vulosi zemrat, ndaj, nuk dinë.

الْخَيْرُ وَأُولَئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ ﴿٨٩﴾

أَعَدَّ اللَّهُ لَهُمْ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا ذَلِكَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ ﴿٩٠﴾

وَجَاءَ الْمُعَذِّرُونَ مِنَ الْأَعْرَابِ لِيُؤْذَنَ لَهُمْ وَقَعَدَ الَّذِينَ كَذَبُوا اللَّهَ وَرَسُولَهُ سَيُصِيبُ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿٩١﴾

لَيْسَ عَلَى الضُّعَفَاءِ وَلَا عَلَى الْمَرْضَى وَلَا عَلَى الَّذِينَ لَا يَجِدُونَ مَا يُنْفِقُونَ حَرَجٌ إِذَا نَصَحُوا لِلَّهِ وَرَسُولِهِ مَا عَلَى الْمُحْسِنِينَ مِنْ سَبِيلٍ وَاللَّهُ غَفُورٌ رَحِيمٌ ﴿٩٢﴾

وَلَا عَلَى الَّذِينَ إِذَا مَا اتَّوَكَّلْتَ لِيُحْمِلَهُمْ قُلْتَ لَا أُحْمِلُهُم عَلَيْهِمْ تَوَلَّوْا وَ أَعْيُنُهُمْ تَفِيضُ مِنَ الدَّمْعِ حَرَنًا أَلَّا يَجِدُوا مَا يُنْفِقُونَ ﴿٩٣﴾

إِنَّمَا السَّبِيلُ عَلَى الَّذِينَ يَسْتَأْذِنُونَكَ وَهُمْ أَغْنِيَاءُ رَضُوا بِأَنْ يَكُونُوا مَعَ الْخَوَالِفِ وَطَبَعَ اللَّهُ عَلَى قُلُوبِهِمْ فَهُمْ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٩٤﴾

94. Do t'ju justifikohen, kur ju të ktheheni te ta. Thuaj: “Mos u justifikoni; ne nuk do t'ju besojmë kurrë; Allahu na ka njoftuar për lajmet tuaja; Allahu e sheh punën tuaj, gjithashtu edhe i Dërguari i Tij; më pas, ju do të ktheheni tek i Dijshmi i së fshehtës dhe i së dukshmes, pra, Ai do t'ju njoftojë për atë që bënit.”

95. Pa dyshim, kur ju të ktheheni te ta, ata do t'ju betohen për Allahun që t'i lini mënjane. Andaj, lërinia ata! Sigurisht, ata janë të papastër dhe streha e tyre është xhehenemi, si dënim i asaj që ata punuan.

96. Do t'ju betohen, që ju të kënaqeni me ta. Edhe sikur të kënaqeni me ta, (ta dini se) Allahu nuk kënaqet me njerëzit e ligj.

97. Beduinët janë më të ashpër në mohim dhe në hipokrizi dhe më së shumti priren të mos njohin kufijtë e asaj që ka zbritur Allahu mbi të Dërguarin e Tij. Allahu është i Gjithëdijshëm, i Urtë.

98. Prej beduinëve ka edhe nga ata që atë të cilën e shpenzojnë (në rrugën e Allahut) e quajnë gjobë dhe presin fatkeqësitë e kohës për ju. Atyre do t'u bien fatkeqësitë e kohës! Allahu është Gjithëdëgjues, i Gjithëdijshëm.

99. Dhe po prej beduinëve ka edhe të atillë, që besojnë Allahun dhe Ditën e *Ahiritit* dhe ato që i shpenzojnë (në

يَعْتَدِرُونَ وَإِيَّكُمْ إِذَا رَجَعْتُمْ إِلَيْهِمْ ۗ قُلْ لَا تَعْتَدِرُوا لَنْ نُؤْمِنَ لَكُمْ قَدْ نَبَأْنَا اللَّهُ مِنْ أَجَابِكُمْ ۗ وَسَيَرَى اللَّهُ عَمَلَكُمْ وَرَسُولُهُ ثُمَّ تُرَدُّونَ إِلَىٰ عِلْمِ الْغَيْبِ وَالشَّهَادَةِ فَيُنَبِّئُكُمْ بِمَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ ﴿٩٤﴾

سَيَخْلِفُونَ بِاللَّهِ لَكُمْ إِذَا انْقَلَبْتُمْ إِلَيْهِمْ لِنِعْرِضُوا عَنْهُمْ ۗ فَأَعْرِضُوا عَنْهُمْ ۗ إِنَّهُمْ رِجْسٌ ۗ وَمَا لَهُمْ جَهَنَّمَ جَزَاءً بِمَا كَانُوا يَكْسِبُونَ ﴿٩٥﴾

يَخْلِفُونَ لَكُمْ لِتَرْضَوْا عَنْهُمْ ۗ فَإِنْ تَرْضَوْا عَنْهُمْ فَإِنَّ اللَّهَ لَا يَرْضَىٰ عَنِ الْقَوْمِ الْفَاسِقِينَ ﴿٩٦﴾

الْأَعْرَابِ أَشَدَّ كُفْرًا وَ نِفَاقًا وَ أَجْدَرُ أَلَّا يَعْلَمُوا حُدُودَ مَا أَنْزَلَ اللَّهُ عَلَىٰ رَسُولِهِ ۗ وَ اللَّهُ عَلِيمٌ حَكِيمٌ ﴿٩٧﴾

وَ مِنَ الْأَعْرَابِ مَنْ يَتَّخِذُ مَا يُنْفِقُ مَغْرَمًا وَ يَتْرَبُّصُ بِكُمْ الدَّوَابِرَ ۗ عَلَيْهِمْ دَائِرَةُ السَّوْءِ ۗ وَ اللَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ ﴿٩٨﴾

وَ مِنَ الْأَعْرَابِ مَنْ يُؤْمِنُ بِاللَّهِ وَ الْيَوْمِ الْآخِرِ وَ يَتَّخِذُ مَا يُنْفِقُ قُرْبَاتٍ عِنْدَ اللَّهِ

rrugën e Allahut) i quajnë si mjet për t'u afruar me Allahun si dhe për të marrë lutjet e të Dërguarit. Dijeni! Kjo është afruese për ta. Allahu do t'i pranojë ata në mëshirën e Tij. Sigurisht, Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

100. Dhe prej *muhaxhirëve* dhe *ensarëve* që janë fitimtarët e parë,<sup>26</sup> si dhe ata që i ndoqën këta në mirësi, Allahu është i kënaqur prej tyre dhe ata janë të kënaqur prej Tij. Dhe Ai u ka përgatitur kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Ata në to do të jetojnë përgjithmonë. Ky është suksesi madhështor!<sup>27</sup>

101. Prej beduinëve që keni përreth, ka edhe hipokritë, dhe prej banorëve të Medinës gjithashtu; ngulmuan në hipokrizi. Ti nuk i njeh ata, Ne i njohim. Do t'i ndëshkojmë dy herë, më pas do (t'i bëjmë) të drejtohen drejt një ndëshkimi të madh.

وَصَلَوَاتِ الرَّسُولِ ۖ أَلَا إِنَّهَا قُرْبَةٌ لَّهُمْ ۗ  
سَيَدْخِلُھُمْ اللّٰهُ فِي رَحْمَتِهِ ۗ إِنَّ اللّٰهَ غَفُورٌ  
رَّحِيمٌ ﴿٩١﴾

وَالسَّامُونَ الْأَوْلُونَ ۖ مِنَ الْمُهَاجِرِينَ  
وَالْأَنْصَارِ وَالَّذِينَ اتَّبَعُوهُمْ بِإِحْسَانٍ ۗ  
رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمْ وَرَضُوا عَنْهُ ۗ وَأَعَدَّ  
لَهُمْ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ  
فِيهَا أَبَدًا ۗ ذَلِكَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ ﴿١٠٠﴾

وَمِمَّنْ حَوْلَكُم مِّنَ الْأَعْرَابِ مُنْفِقُونَ ۗ  
وَمِنَ أَهْلِ الْمَدِينَةِ مَن قَدْ مَرَدُّوا عَلَى  
الْإِثْقاقِ ۗ لَا تَعْلَمُهُمْ ۗ نَحْنُ نَعْلَمُهُمْ ۗ  
سَمْعَدٌ بِهِمْ مَّرَّتَيْنِ ثُمَّ يُرَدُّونَ إِلَىٰ عَذَابِ  
عَظِيمٍ ﴿١٠١﴾

26. Të gjitha instinktet, duke përfshirë edhe atë të garës, janë të dobishme, vetëm se keqpërdorimi i tyre i bën ato të këqija. Pra, kur përdor një instinkt të caktuar në kohën e gabuar dhe në masën e gabuar, ai të kthehet në ligësi, kurse përdorimi i saktë i tij, të sjell shpërblim prej Zotit. Diku tjetër në Kuranin e Shenjtë, Zoti na mëson lutjen: “O Zoti im, më mbro nga e keqja e ziliqarit kur shfaq zili!” (113:6), kurse në shumë ajete të tjera na nxit për garën (2:149; 57:22 etj.), si këtu duke dhënë shembullin e “*fitimtarëve të parë*” (arab. *sābikūn* d.m.th. *garuesit fitimtarë*). Dihet që gara të kërkon të kesh një lloj zilie në shpirt. Cili garues pëlqen që dikush tjetër ta parakalojë atë?! Realisht, njeriu e ka këtë instinkt që nga vogëlia, përndryshe fëmijët nuk do të përpiqeshin dhe nuk do të përparonin në dije e në virtyte. Kurse atyre që përpiqen, Zoti ua shton edhe më shumë aftësitë. Në këtë kuptim, edhe garuesit në besim janë edhe “lakmitarë”, por të pastër nga e keqja e lakmisë.

27. Ky ajet flet, ndër të tjera, për pozitën e lartë të sahabëve të Profetit Muhammed<sup>savs</sup>. Më shumë për këtë temë, lexoni edhe 33:24; 58:23.

102. Ka edhe të tjerë që pranuan mëkatet e tyre, ata i kanë përzier veprat e mira me veprat e tjera të këqija. Mundet që Allahu t'ua pranojë pendesën. Sigurisht, Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

وَأَخْرُونَ اعْتَرَفُوا بِذُنُوبِهِمْ خَلَطُوا عَمَلًا صَالِحًا وَآخَرَ سَيِّئًا عَسَى اللَّهُ أَنْ يَتُوبَ عَلَيْهِمْ إِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَحِيمٌ ﴿١٠٢﴾

103. Prano *sadaka* nga pasuritë e tyre. Me anë të kësaj, ti do t'i pastrosh dhe do t'i dëlirësosh, dhe lutu për ta. Sigurisht, lutja jote është qetësi për ta. Allahu është Gjithëdhëgjues, i Gjithëdijshëm.<sup>28</sup>

خُذْ مِنْ أَمْوَالِهِمْ صَدَقَةً تُطَهِّرُهُمْ وَتُزَكِّيهِمْ بِهَا وَصَلِّ عَلَيْهِمْ إِنَّ صَلَاتَكَ سَكَنٌ لَهُمْ وَاللَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ ﴿١٠٣﴾

104. A nuk e dinë ata që vetëm Allahu ua pranon pendesën robërve të Tij dhe ua pranon *sadakatë* dhe se pikërisht Allahu është Pendimpranuesi, Mëshirëbërësi?!

أَلَمْ يَعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ هُوَ يَقْبَلُ التَّوْبَةَ عَنْ عِبَادِهِ وَيَأْخُذُ الصَّدَقَاتِ وَأَنَّ اللَّهَ هُوَ التَّوَّابُ الرَّحِيمُ ﴿١٠٤﴾

105. Thuaj: Punoni, sepse Allahu sheh punën tuaj, edhe i Dërguari i Tij edhe besimtarët. Dhe ju do të ktheheni tek i Dijshmi i së padukshmes dhe i së dukshmes, atëherë Ai do t'ju njoftojë për atë që bënit.

وَقُلْ اعْمَلُوا فَسَيَرَى اللَّهُ عَمَلَكُمْ وَرَسُولُهُ وَالْمُؤْمِنُونَ وَسَتُرَدُّونَ إِلَىٰ عِلْمِ الْغَيْبِ وَالشَّهَادَةِ فَيُنبِّئُكُمْ بِمَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ ﴿١٠٥﴾

106. Dhe ka të tjerë të lënë në pritje të urdhrit të Allahut, daç i ndëshkon ose daç ua pranon pendesën. Allahu është i Gjithëdijshëm, i Urtë.

وَأَخْرُونَ مُرَجُونَ لِأَمْرِ اللَّهِ إِمَّا يُعَذِّبُهُمْ وَإِمَّا يَتُوبُ عَلَيْهِمْ وَاللَّهُ عَلِيمٌ حَكِيمٌ ﴿١٠٦﴾

107. (Prej hipokritëve janë) edhe ata që ndërtuan një xhami për të lënduar, për të mohuar, për të krijuar ndasi mes besimtarëve dhe për t'i mundësuar atij, që ka luftuar kundër

وَالَّذِينَ اتَّخَذُوا مَسْجِدًا ضَرَارًا وَكُفْرًا وَتَفْرِيقًا بَيْنَ الْمُؤْمِنِينَ وَإِرْصَادًا لِّمَنْ حَارَبَ اللَّهَ وَرَسُولَهُ مِنْ قَبْلُ وَلَيَحْلِفْنَ

28. Ky ajet tregon se ndërmjetësimi (arab. *shefa'at*) nga ana e Profetit me lejen e Zotit është i vërtetë si koncept, siç e thotë: "Sigurisht, lutja jote është qetësi për ta". Për shkak të lutjes së Profetit ndodh që besimtari fiton gjallëri shpirtërore dhe ftohje në mëkatet dhe epshet e tij.

Allahut dhe të Dërguarit të Tij (edhe) më parë, t'u bëjë pritë (muslimanëve). Ata patjetër do të betohen: “Donim vetëm të mirën”. Allahu dëshmon se ata janë gënjeshtarë.<sup>29</sup>

108. Kurrsesi mos qëndro në të. Vetëm xhamia që u themelua mbi druajtjen (ndaj Zotit) që nga dita e parë, meriton më shumë të qëndrosh (për falje) në të. Në të ka burra që dëshirojnë të dëlirësohen. Dhe Allahu i do të dëlirësuarit.

109. Andaj, a është më i mirë ai që themeloi ngrehinën e tij mbi druajtjen prej Allahut dhe pëlqimin (e Tij), apo ai që themeloi ngrehinën e tij mbi një breg të gërryer që rrëshqet, për të rënë përfundimisht së bashku me të në zjarrin e xhehenemit?! Allahu nuk i udhëzon njerëzit e padrejtë.

110. Ngrehinën që ata e ndërtuan, gjithmonë do të krijojë mëdysheje në zemrat e tyre, përveçse nëse u copëtohen zemrat (nga frika ndaj Allahut). Allahu është i Gjithëdijshëm, i Urtë.

111. Allahu ua bleu besimtarëve jetët dhe pasuritë e tyre, duke u siguruar xhenetin. Ata luftojnë në rrugën e Allahut, andaj, vrasin e vriten. Premtim i vërtetë që Ai e ka marrë përsipër (që përmendet) në

إِن أَرَدْنَا إِلَّا الْحُسْنَىٰ ۗ وَاللَّهُ يَشْهَدُ إِنَّهُمْ لَكَاذِبُونَ ﴿١٠٨﴾

لَا تَقُمْ فِيهِ أَبَدًا ۗ لِمَسْجِدٍ أُسِّسَ عَلَى التَّقْوَىٰ مِنْ أَوَّلِ يَوْمٍ أَحَقُّ أَنْ تَقُومَ فِيهِ ۗ فِيهِ رِجَالٌ يُحِبُّونَ أَنْ يَتَّطَهَّرُوا ۗ وَاللَّهُ يُحِبُّ الْمُطَهَّرِينَ ﴿١٠٩﴾

أَفَمَنْ أُسِّسَ بُيُوتُهُ عَلَى تَقْوَىٰ مِنَ اللَّهِ وَرِضْوَانٍ خَيْرٌ أَمْ مَنْ أُسِّسَ بُيُوتُهُ عَلَى شَفَا جُرْفٍ هَارٍ فَأَنْهَارَ بِهِ فِي نَارِ جَهَنَّمَ ۗ وَاللَّهُ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الظَّالِمِينَ ﴿١١٠﴾

لَا يَزَالُ بُنْيَانُهُمُ الَّذِي بَنَوْا رِيبَةً فِي قُلُوبِهِمْ إِلَّا أَنْ تَقَطَّعَ قُلُوبُهُمْ ۗ وَاللَّهُ عَلِيمٌ حَكِيمٌ ﴿١١١﴾

إِنَّ اللَّهَ اشْتَرَى مِنَ الْمُؤْمِنِينَ أَنفُسَهُمْ وَأَمْوَالَهُمْ بِأَنْ لَهُمُ الْجَنَّةُ ۗ يُقَاتِلُونَ فِي سَبِيلِ اللَّهِ فَيَقْتُلُونَ وَيُقْتَلُونَ ۗ وَعَدَا عَلَيْهِ حَقًّا فِي التَّوْبَةِ وَالْإِنجِيلِ

29. Urdhri për ta shembur *xhaminë e dëmshme* (të ndërtuar nga hipokritët) ka ardhur për shkak se ishte e qartë që ajo ishte fole e intrigave të mohuesve kundër Islamit, përndryshe nderimi i xhamive është detyrim në Islam.

Teurat, Inxhil<sup>30</sup> dhe Kuran. E kush e përmbush premtimin e vet më shumë se Allahu?! Andaj, gëzohuni për tregtinë që keni bërë me Të. Dhe ky pikërisht është sukcesi madhështor.

112. Të penduarit, adhuresit, lavdëruesit, udhëtarët (në rrugë të Zotit), të përkulurit në *ruku*, të rënë në *sexhde*, urdhëruesit për të mirën, ndaluesit nga e keqja, mbrojtësit e kufijve të Allahut (janë besimtarë të vërtetë), dhe jepu lajm të gëzueshëm besimtarëve.

113. Nuk u lejohet Profetit dhe atyre që besuan, të kërkojnë falje për idhujtarët, edhe qofshin të afërm, pasi që u është bërë e qartë se ata janë banorë të xhehenemit.

114. Kurse kërkimi i faljes nga Ibrahim për babanë e tij ishte vetëm për shkak të premtimit që ai i kishte bërë atij. E kur atij iu bë e qartë se ai ishte armik i Allahut, u distanca prej tij. Sigurisht, Ibrahim ishte shumë i dhembshur, durimtar.

115. Allahu nuk devijon një popull, pasi e udhëzon, gjersa ua bën të qartë se nga çfarë duhet të ruhen ata. Sigurisht, Allahu është i Gjithëdijshtëm për çdo gjë.

116. Pa dyshim, i Allahut është sundimi i qiejve dhe i tokës. Ai jep jetën dhe vdekjen. Përveç Allahut nuk keni asnjë mik e as ndihmës.

وَالْقُرْآنُ<sup>ط</sup> وَمَنْ أَوْفَىٰ بِعَهْدِهِ مِنَ اللَّهِ فَاسْتَبْشِرُوا بِبَيْعِكُمُ الَّذِي بَايَعْتُمْ بِهِ<sup>ط</sup> وَذَلِكَ هُوَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ<sup>١١٣</sup>

الَّتَابِعُونَ الْعِدَّةَ الْحَمْدُونَ السَّاجِدُونَ  
الرُّكُوعُونَ السُّجُودَ وَالْأَمْرُونَ بِالْمَعْرُوفِ  
وَالنَّاهُونَ عَنِ الْمُنْكَرِ وَالْحَفِظُونَ لِحُدُودِ  
اللَّهِ<sup>ط</sup> وَبَشِّرِ الْمُؤْمِنِينَ<sup>١١٣</sup>

مَا كَانَ لِلنَّبِيِّ وَالَّذِينَ آمَنُوا أَنْ يَسْتَغْفِرُوا  
لِلْمُشْرِكِينَ وَلَوْ كَانُوا أُولِي قُرْبَىٰ مِنْ بَعْدِ  
مَا تَبَيَّنَ لَهُمْ أَنَّهُمْ أَصْحَابُ الْجَحِيمِ<sup>١١٣</sup>

وَمَا كَانَ اسْتِغْفَارُ إِبْرَاهِيمَ لِأَبِيهِ إِلَّا عَن  
مَوْعِدَةٍ وَعَدَهَا إِيَّاهُ<sup>ج</sup> فَلَمَّا تَبَيَّنَ لَهُ أَنَّهُ  
عَدُوٌّ لِلَّهِ تَبَرَّأَ مِنْهُ<sup>ط</sup> إِنَّ إِبْرَاهِيمَ لَأَوَّاهٌ  
حَلِيمٌ<sup>١١٤</sup>

وَمَا كَانَ اللَّهُ لِيُضِلَّ قَوْمًا بَعْدَ إِذْ هَدَاهُمْ  
حَتَّىٰ يُبَيِّنَ لَهُمْ مَا يَتَّقُونَ<sup>ط</sup> إِنَّ اللَّهَ بِكُلِّ  
شَيْءٍ عَلِيمٌ<sup>١١٥</sup>

إِنَّ اللَّهَ لَهُ مَلَكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ<sup>ط</sup>  
يُعِی وَيُمِیتُ<sup>ط</sup> وَمَا لَكُمْ مِّنْ دُونِ اللَّهِ  
مِنْ وَّلِيٍّ وَلَا نَصِيرٍ<sup>١١٦</sup>

30. Bibla, Ligji i Përtërirë 6:3-5; Mateu: 19:21 dhe 19:27-29.

117. Sigurisht, Allahu ua pranoi pendesën Profetit, *muhaxhirëve* dhe *ensarëve*, të cilët e ndoqën në kohë vështirësie, në një kohë kur mundej që t'i shtrembëroheshin zemrat një grupi të tyre, e megjithatë, Allahu ua pranoi pendesën. Njëmend, Ai ndaj tyre është shumë i Dhembshur, shumë Mëshirëbërës.

لَقَدْ تَابَ اللَّهُ عَلَى النَّبِيِّ وَالْمُهَاجِرِينَ  
وَالْأَنْصَارِ الَّذِينَ اتَّبَعُوهُ فِي سَاعَةِ الْعُسْرَةِ  
مِنْ بَعْدِ مَا كَادَ يَزِيغُ قُلُوبَ فَرِيقٍ مِنْهُمْ  
ثُمَّ تَابَ عَلَيْهِمْ إِنَّهُ بِهِمْ رَءُوفٌ  
رَحِيمٌ ﴿١١٧﴾

118. Edhe atyre të treve që mbetën mbrapa, derisa toka, pavarësisht nga gjerësia e saj, iu bë e ngushtë dhe atyre iu ngushtuan shpirtrat, gjersa kuptuan se nuk ka strehë nga Allahu, përveç Atij. Pastaj, Ai i mëshiroi që ata të pendoheshin. Pikërisht Allahu është Pendimpranuesi, Mëshirëbërësi.<sup>31</sup>

وَعَلَى الثَّلَاثَةِ الَّذِينَ خَلَفُوا حَتَّىٰ إِذَا  
ضَاقَتْ عَلَيْهِمُ الْأَرْضُ بِمَا رَحُبَتْ وَضَاقَتْ  
عَلَيْهِمْ أَنفُسُهُمْ وَظَنَّوْا أَنَّهُ لَا مَلْجَأَ مِنَ  
اللَّهِ إِلَّا إِلَيْهِ ثُمَّ تَابَ عَلَيْهِمْ لِيَتُوبُوا  
إِنَّ اللَّهَ هُوَ التَّوَّابُ الرَّحِيمُ ﴿١١٨﴾

119. O ju që besuat! Kini druajtje ndaj Allahut dhe bëhuni me të vërtetët.<sup>32</sup>

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَكُونُوا مَعَ  
الصَّادِقِينَ ﴿١١٩﴾

120. Banorët e Medinës dhe beduinët që jetojnë rreth tyre nuk duhej ta linin të Dërguarin e

مَا كَانَ لِأَهْلِ الْمَدِينَةِ وَمَنْ حَوْلَهُمْ مِنَ  
الْأَعْرَابِ أَنْ يَتَخَلَّفُوا عَنْ رَسُولِ اللَّهِ

31. Bëhet fjalë për tre sahabë të cilët mbetën pa shkuar në betejën e Tebukut dhe kur Profeti<sup>savs</sup>, pasi ishte kthyer nga beteja, u kërkoi arsyen, ata nuk gënjenen dhe treguan të vërtetën se nuk kishin asnjë arsye që të mungonin, edhe pse kishte plot hipokritë që dhanë justifikime të gënjeshtërtë. Këta tre sahabë ishin Ka'b bin Maliku<sup>ra</sup>, Hilal bin Umejje<sup>ra</sup> dhe Murara bin Rebi'a<sup>ra</sup>. Atyre që dhanë justifikime të ndryshme Profeti<sup>savs</sup> nuk u dha asnjë dënim, por këta të tre i dënoi me bojkotim. Ata mbetën nën këtë dënim jo më pak se pesëdhjetë ditë. Këtë periudhë ata e kaluan me një pendesë shembullore, siç përshkruhet në këtë ajet. Më vonë, Allahu e dërgoi shpalljen që Ai ua fali gabimin (Buhari, nr. 4677). Këtu kuptojmë edhe faktin se çfarë bindje të patundur kishte Profeti Muhammed<sup>savs</sup> në Zotin e Madhërisëm dhe në Ditën e Gjykimit, sepse dënimin më shumë e meritonin hipokritët që gënjenen sesa këta tre sahabë. Çështjen e gënjeshtarëve Profeti<sup>savs</sup> e la për Ditën e Gjykimit.

32. Librat Hyjnorë janë thesare të pashtershme të urtësive, por këto urtësi nuk i arrin dot në mënyrë të plotë, derisa nuk shoqërohen me gjithë sinqeritet e përkushtim me *njeriun e vërtetë* (arab. *sādik*), pra me atë që pasqyron vërtetësinë me gjithë qenien e tij.



Allahut e të mbeteshin mbrapa dhe nuk duhej ta parapëlqenin veten karshi tij. Kjo (sakrificë jetësh është e domosdoshme) sepse çdo etje, çdo vështirësi dhe çdo uri që ata përballojnë në rrugën e Allahut, çdo rrugë që bëjnë (dhe) që i zemëron mohuesit dhe çdo gjë që arrijnë prej armikut (gjatë luftës), për të gjitha këto u shënohet nga një vepër e mirë. Sigurisht, Allahu nuk ua humb shpërblimin mirëbërësve.<sup>33</sup>

121. Gjithashtu, për çdo shpenzim që ata bëjnë, qoftë të vogël, qoftë të madh, dhe për çdo vend që kalojnë duke udhëtuar, u shënohet, në mënyrë që Allahu t'ua shpërblejë sipas veprave më të mira që ata bënin.

122. Për besimtarët nuk është e mundur të dalin që të gjithë. Pse të mos dalë një grup nga çdo shtresë e tyre, që të mësojnë për fenë dhe ata ta paralajmërojnë popullin e tyre kur të kthehen te ta, në mënyrë që të shpëtojnë (nga shkatërrimi)?<sup>34</sup>

123. O ju që besuat! Luftoni kundër të afërmve tuaj që janë mohues dhe ata le ta ndiejnë ashpërsinë tuaj. Dhe dijeni se Allahu është me ata që kanë drojë (ndaj Allahut).

وَلَا يَرْغَبُوا بِأَنْفُسِهِمْ ۗ ذَلِكَ  
بِأَنَّهُمْ لَا يُصِيبُهُمْ ظَمَأٌ وَلَا نَصَبٌ  
وَلَا مَخْمَصَةٌ فِي سَبِيلِ اللَّهِ وَلَا يَطَّوِّئُونَ  
مَوْطِئًا يَغِيظُ الْكُفَّارَ وَلَا يَنَالُونَ مِنْ  
عَدُوِّ نِيْلًا إِلَّا كَتَبَ لَهُمْ بِهِ عَمَلٌ صَالِحٌ  
إِنَّ اللَّهَ لَا يُضِيعُ أَجْرَ الْمُحْسِنِينَ ﴿٣٣﴾

وَلَا يُنْفِقُونَ نَفَقَةً صَغِيرَةً وَلَا كَبِيرَةً  
وَلَا يَقْطَعُونَ أَوْدِيًا إِلَّا كَتَبَ لَهُمْ لِيَجْزِيَهُمْ  
اللَّهُ أَحْسَنَ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿٣٤﴾

وَمَا كَانَ الْمُؤْمِنُونَ لِيَنْفِرُوا كَافَّةً ۗ  
فَلَوْ لَا نَفَرَ مِنْ كُلِّ فِرْقَةٍ مِنْهُمْ طَائِفَةٌ  
لِيَتَفَقَّهُوا فِي الدِّينِ وَلِيُنذِرُوا قَوْمَهُمْ إِذَا  
رَجَعُوا إِلَيْهِمْ لَعَلَّهُمْ يَحْذَرُونَ ﴿٣٥﴾

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا قَاتِلُوا الَّذِينَ يَلُونَكُمْ  
مِنَ الْكُفَّارِ وَلْيَجِدُوا فِيكُمْ غِلْظَةً ۗ  
وَاعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ مَعَ الْمُتَّقِينَ ﴿٣٦﴾

33. Edhe pse Allahu nuk ua humb shpërblimin mirëbërësve, mirëbërësit nuk duhet ta bëjnë mirësinë thjesht për ta fituar shpërblimin.

34. Mungesa e njohurive dhe mungesa e trajnimit shkaktojnë dobësi në besim dhe në kryerjen e veprave të mira, andaj ajeti parashtron metodën se si mund të organizohen besimtarët për të mos pasur këtë dobësi.

124. E sa herë që zbret ndonjë sure, ka prej tyre që thonë: “Kë prej jush e ka shtuar në besim kjo?!” Ata që besuan, patjetër që i ka shtuar në besim dhe ata ndihen të gëzuar (për të ardhmen).

وَإِذَا مَا أَنْزَلَتْ سُورَةً فَمِنْهُمْ مَّنْ يَقُولُ  
أَيُّكُمْ زَادَتْهُ هَذِهِ إِيْمَانًا ۚ فَأَمَّا الَّذِينَ آمَنُوا  
فَزَادَتْهُمْ إِيمَانًا وَهُمْ يَسْتَبْشِرُونَ ﴿١٢٤﴾

125. Kurse ata që kanë “sëmundje” në zemër, kjo (sure) i shton ndyrësisë së tyre ndyrësi edhe më shumë dhe ata vdesin duke qenë mohues.

وَأَمَّا الَّذِينَ فِي قُلُوبِهِمْ مَّرَضٌ فَزَادَتْهُمْ  
رِجْسًا إِلَىٰ رِجْسِهِمْ وَمَاتُوا وَهُمْ كَافِرُونَ ﴿١٢٥﴾

126. A nuk shohin vallë se ata sprovohen çdo vit një ose dy herë?! Prapë as nuk pendohen e as nuk mendohen.

أَوَلَا يَرَوْنَ أَنَّهُمْ يُفْتَنُونَ فِي كُلِّ عَامٍ  
مَّرَّةً أَوْ مَرَّتَيْنِ ثُمَّ لَا يَتُوبُونَ وَلَا هُمْ  
يَذْكُرُونَ ﴿١٢٦﴾

127. E sa herë zbret ndonjë sure, disa prej tyre shohin disa të vetët, (sikur u thonë:) “Mos po ju sheh njeri?” pastaj kthehen mbrapsht. Allahu ua ktheu zemrat mbrapsht, sepse ishin njerëz që nuk kuptonin.

وَإِذَا مَا أَنْزَلَتْ سُورَةً نَّظَرَ بَعْضُهُمْ إِلَىٰ  
بَعْضٍ ۗ هَلْ يَرِيكُمْ مِنْ أَحَدٍ ثُمَّ انصَرَفُوا  
صَرَفَ اللَّهُ قُلُوبَهُمْ بِأَنَّهُمْ قَوْمٌ  
لَّا يَفْقَهُونَ ﴿١٢٧﴾

128. Sigurisht, juve ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj; i vjen shumë rëndë kur ju jeni në vështirësi, është i etur për ju, shumë i dhembshur (e) mëshirëbërës ndaj besimtarëve.<sup>35</sup>

لَقَدْ جَاءَكُمْ رَسُولٌ مِّنْ أَنفُسِكُمْ عَزِيزٌ  
عَلَيْهِ مَا عَنِتُّمْ حَرِيصٌ عَلَيْكُمْ  
بِالْمُؤْمِنِينَ رَءُوفٌ رَّحِيمٌ ﴿١٢٨﴾

35. Ky ajet tregon sjelljen e Profetit<sup>savs</sup> si me besimtarët ashtu edhe me jobesimtarët. Pjesa e parë e tij përveç besimtarëve u referohet edhe mohuesve. Pra, me fjalë të tjera, ajeti thotë – Ky Profet vuan kur i sheh ata duke vuajtur, pavarësisht nga persekutimet që ata u bëjnë muslimanëve. Edhe në një ajet tjetër të Kuranit, duke iu drejtuar Profetit<sup>savs</sup>, Zoti thotë – A do të vrasësh veten se pse ata nuk po bëhen besimtarë?! (26:4). Në një ajet tjetër, thotë – Ne nuk të kemi dërguar ty, përveçse si mëshirë për botët (21:108). Kurse pjesa e fundit tregon ndjenjat e Profetit<sup>savs</sup> sidomos për besimtarët. Pra, në dhembshuri dhe në mëshirë, ai është shëmbëllturye e atributëve të Zotit. Andaj, për ta ai është më shumë se një baba i dashur dhe më shumë se një nënë e mëshirshme.

129. E nëse ata e kthejnë shpinën, thuaj: Më mjafton Allahu; nuk ka të adhurueshëm tjetër veç Atij; Atij iu mbështeta dhe Ai është Zoti i Arshit të madh.

فَإِنْ تَوَلَّوْا فَقُلْ حَسْبِيَ اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ عَلَيْهِ تَوَكَّلْتُ وَهُوَ رَبُّ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ ﴿١٢٩﴾

## Surja 10 – Junus

Surja Junus është mekase dhe bashkë me *bismil-lahin*, ka njëqind e dhjetë ajete.

Në suret El-Bekare dhe Ali Imran shkurtesat janë *elif-lam-mim*, kurse në këtë sure, në vend të shkronjës –*mim*, vjen –*ra*. Duke ndjekur metodën e përkthimit, sikurse tek *Elif-lam-mim*-i, këto shkronja mund t'i përkthejmë: “*Enellahu era*”, që do të thotë: “Unë jam Allahu; Unë shoh”.

Tema qendrore e kësaj sureje është sprova që i bie *Hazret Junusit*<sup>as</sup>, dhe kjo është edhe arsyeja e emërimit të saj. Që në krye të saj, Zoti i Madhërishëm ngre një pyetje – A është e habitshme për njerëzit që Unë të zgjedh një prej tyre dhe t'i dërgoj shpallje?! Përgjigjja e nënkuptuar është që habia e njerëzve vjen për shkak të gjendjes së tyre, sepse janë bërë tërësisht tokësorë, andaj Allahu nuk u dërgon atyre ndonjë shpallje. Kështu që, duke e parë veten bosh në këtë aspekt, ata mendojnë se Allahu i Madhërishëm nuk mund t'i dërgojë shpallje askujt.

Menjëherë pas kësaj, ngrihet pyetja se Allahu i Madhërishëm a mund ta ketë krijuar gjithësinë pa qëllim, duke bërë seleksionimin e duhur në çdo çështje?! Jo. Njëri prej qëllimeve të këtij projekti, është krijimi i një robi ndërmjetës, Profeti Muhammed<sup>savs</sup>, i cili, me lejen e Allahut të Madhërishëm, jo vetëm që do të ndërmjetësojë njerëzit nevojtarë të *umetit* të vet, por robër të mirë edhe të *umeteve* të mëparshme.

Pas kësaj, shembulli i Profetit Muhammed<sup>savs</sup> është dhënë me diellin shpirtëror, energjia e të cilit mban jetën shpirtërore në tokë dhe se po me energjinë e tij do të shfaqej edhe një hënë e plotë shpirtërore, që do ta ndriçojë tokën me dritën e këtij dielli edhe gjatë errësirave të natës.

Është e çuditshme që edhe në botën lëndore disa bimë rriten gjatë natës nën dritën e hënës, aq saqë ato krijojnë edhe tinguj për shkak të rritjes së shpejtë. Kështu, shkencëtarët pohojnë se disa lloje trangujsh, për shkak të rritjes së tyre të shpejtë, bëjnë një zhurmë, të cilën mund ta dëgjojnë edhe njeriu. Andaj, është i njëjti Allah që bëri mjet për të siguruar jetën jo vetëm ditën, por edhe natën.

Surja Junus flet për një popull që shpëtoi tërësisht nga ndëshkimi që u ishte parashikuar. Kurse surja vijuese, Hud, përmend popujt që u shkatërruan tërësisht për shkak të mohimit dhe të ligësive të tyre.



Ajetet:  
110

سُورَةُ يُنُوسَ  
10. JUNUS  
Mekase

Rukutë:  
11

1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. *Elif.Lam.Ra.* (Unë jam Allahu që shoh.) Këto janë ajete të Librit urtiplotë.

أَلَمْ تَرَ أَنَّا أَرْسَلْنَا بِكَ آيَاتِنَا بِالْحَقِّ ①

3. A është e habitshme për njerëzit që Ne i shpallëm një burri mes tyre, që ai t'i alarmojë njerëzit dhe t'u japë lajm të mirë atyre që besuan që hapi i tyre është mbi të vërtetën pranë Zotit të tyre?! Mohuesit thanë: "Ky përnjëmend është magjistar i hapur!"

أَكَانَ لِلنَّاسِ عَجَبًا أَنْ أَوْحَيْنَا إِلَى رَجُلٍ مِنْهُمْ أَنْ أَنْذِرِ النَّاسَ وَبَشِّرِ الَّذِينَ آمَنُوا أَنْ لَهُمْ قَدَمٌ صَدَقَ عِنْدَ رَبِّهِمْ ① قَالَ الْكٰفِرُونَ إِنَّ هَذَا لَسِحْرٌ مُّبِينٌ ②

4. Sigurisht, Zoti juaj është Allahu që krijoi qiejt dhe tokën në gjashtë ditë e më pas u vendos në Arsh. Ai drejton çështjen. Nuk ka ndonjë ndërmjetës, veçse me lejen e Tij. Ky është Allahu, Zoti juaj, andaj adhurojeni Atë. A nuk mendoheni?!<sup>1</sup>

إِنَّ رَبَّكُمُ اللَّهُ الَّذِي خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ فِي سِتَّةِ أَيَّامٍ ثُمَّ اسْتَوَىٰ عَلَى الْعَرْشِ يُدَبِّرُ الْأَمْرَ ۗ مَا مِنْ شَفِيعٍ إِلَّا مِنْ بَعْدِ إِذْنِهِ ۗ ذَلِكُمُ اللَّهُ رَبُّكُمْ فَاعْبُدُوهُ ۗ أَفَلَا تَذَكَّرُونَ ①

5. Tek Ai do të ktheheni të gjithë. Ky është premtimi i vërtetë i Allahut. Sigurisht, Ai nis krijimin, më pas e përsërit atë, në mënyrë që t'i shpërblejë me drejtësi ata që besuan dhe bënë të mira. Kurse ata që mohuan, do të kenë pije të valuar dhe ndëshkim të dhimbshëm, për shkak se e mohonin (të vërtetën).

إِلَيْهِ مَرْجِعُكُمْ جَمِيعًا وَعَدَّ اللَّهُ حَقًّا ۗ إِنَّهُ يَبْدَأُ الْخَلْقَ ثُمَّ يُعِيدُهُ لِيَجْزِيَ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ بِالْقِسْطِ ۗ وَالَّذِينَ كَفَرُوا لَهُمْ شَرَابٌ مِّنْ حَمِيمٍ وَعَذَابٌ أَلِيمٌ بِمَا كَانُوا يَكْفُرُونَ ②

1. Gjashtë ditët e krijimit nënkuptojnë gjashtë etapa të tij. Edhe për krijimin e njeriut, i cili është një mikrokozmos, Kurani përmend gjashtë etapa (23:1-15) dhe duket se gjashtë etapa janë proces i zhvillimit deri në përsosmëri. Më shumë për "gjashtë ditë", lexoni 25:60 dhe për Arshin, 7:55.

6. Është Ai që bëri diellin ndriçues dhe hënën me dritë dhe i përcaktoi destinacione, që të mësoni numrin e viteve dhe llogaritjen. Allahu nuk e krijoi këtë përveçse me vërtetësi. Ai i shpjegon shenjat për njerëzit që dinë.<sup>2</sup>

7. Pa dyshim, në ndërrimin e natës e të ditës dhe në atë që Allahu krijoi në qiejt dhe në tokë, ka shenja për njerëzit që kanë drojë (ndaj Allahut).

8. Njëmend, ata që nuk shpresojnë takimin me Ne dhe e pëlqyen jetën e kësaj bote dhe në të mbetën të kënaqur, si dhe ata që janë shpërfillës ndaj shenjave Tona;

9. pikërisht ata e kanë strehë zjarrin, për shkak të asaj që punuan.

10. Sigurisht, ata që besuan dhe bënë të mira, Zoti i tyre do t'i udhëzojë për shkak të besimit të tyre, në kopshte

هُوَ الَّذِي جَعَلَ الشَّمْسَ ضِيَاءً وَ الْقَمَرَ  
نُورًا وَ قَدَرَهُ مَنَازِلَ لِيَعْلَمُوا عَدَدَ السِّنِينَ  
وَ الْحِسَابَ ۗ مَا خَلَقَ اللَّهُ ذَلِكَ إِلَّا بِالْحَقِّ  
يُفَصِّلُ الْآيَاتِ لِقَوْمٍ يَعْلَمُونَ ①

إِنَّ فِي اخْتِلَافِ اللَّيْلِ وَ النَّهَارِ وَ مَا خَلَقَ اللَّهُ  
فِي السَّمَوَاتِ وَ الْأَرْضِ لآيَاتٍ لِقَوْمٍ  
يَتَّقُونَ ①

إِنَّ الَّذِينَ لَا يَرْجُونَ لِقَاءَنَا وَ رَضُوا  
بِالْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَ اطْمَأَنَّنُوا بِهَا وَ الَّذِينَ هُمْ  
عَنِ آيَاتِنَا غٰفِلُونَ ①

أُولَئِكَ مَا لَهُمْ نَارٌ بِمَا كَانُوا  
يَكْسِبُونَ ①

إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَ عَمِلُوا الصَّالِحَاتِ يَهْدِيهِمْ  
رَبُّهُمْ بِإِيمَانِهِمْ ۗ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهِمْ

2. Ajeti tregon ligjin e natyrës dhe ertësinë që fshihet në të. Ne matim distancën e hapësirës që përshkon një trup qiellor nga ndryshimi i pozicionit të tij në raport me trupat e tjerë. Zoti ka caktuar faza për diellin dhe hënën që ne të mund të bëjmë një llogaritje të kohës. Me fjalë të tjera, Ai i ka bërë këta trupa të lëvizin dhe ua ka caktuar fazat e lëvizjes, në mënyrë që duke vëzhguar lëvizjen e tyre, të jemi në gjendje të dimë kohën dhe se sa kemi lëvizur nga pozicioni ynë fillestar. Të gjitha llogaritë dhe të gjithë kalendarët varen nga lëvizjet e diellit ose të hënës, ose të të dyjave bashkë. Hëna lëviz rreth Tokës, njëkohësisht duke kaluar edhe në fazat e saj, dhe në këtë mënyrë ne jemi në gjendje të llogaritim muajt. Toka lëviz rreth diellit dhe gjithashtu rrotullohet rreth boshtit të saj, duke na mundësuar kështu të masim vitet dhe ditët tona. Një tjetër fakt interesant ky ajeti e përmend me ndryshimin e fjalëve për dritën e diellit dhe atë të hënës. Për diellin, është përdorur fjala arabe “*dijā*”, kurse për hënën “*nur*”. Sipas fjalorëve, *dijā* është dritë e fortë, kurse *nur*, dritë e lehtë, e këndshme, por më e qëndrueshme, andaj, shpesh përdoret edhe në kuptimin figurativ. Për këtë arsye, “*nur*” është një nga atributet e Allahut (Muhit). Disa fjalorë shpjegojnë edhe një aspekt tjetër të këtyre dy dritave: “*dija*” është dritë e mëvetësishme, kurse “*nur*” është dritë që reflektohet (Lane, Akrah), siç e vërteton edhe shkenca për dritën e diellit dhe atë të hënës.

plot bekime, ku rrjedhin lumenj nën komandën e tyre.

الْأَنْهَارُ فِي جَنَّتِ التَّعِيمِ ﴿١٠﴾

11. Thirrja e tyre në to do të jetë: “I Shenjtë je o Allah!” Dhe përshëndetja e tyre në to do të jetë: Paqe! Dhe thirrja e tyre e fundit do të jetë që lavdia është e Allahut, Zotit të botëve.

دَعْوُهُمْ فِيهَا سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ وَتَحِيَّاتُهُمْ فِيهَا سَلَامٌ ۖ وَأٰخِرُ دَعْوَاهُمْ اِنَّ الْحَمْدَ لِلّٰهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿١١﴾

12. Po të nxitonte Allahu për të kapur njerëzit për të keqen, me nxitimin që ata e kërkojnë të mirën, do të ishte ekzekutuar vendimi për afatin e tyre. Ndaj, ata që nuk shpresojnë takimin me Ne, i lëmë të vërtiten në tërbimin e tyre.

وَلَوْ يَعْجَلُ اللّٰهُ لِلنَّاسِ الشَّرَّ اسْتَعَجَلَهُمْ بِالْخَيْرِ لَنَقَضِيَ اِلَيْهِمْ اَجَلَهُمْ طَفَنَدُرُ الَّذِينَ لَا يَرْجُونَ لِقَاءَنَا فِي طُعْيَانِهِمْ يَعْمَهُونَ ﴿١٢﴾

13. Kur njeriun e prek dhimbja, Na lutet i shtrirë, i ulur ose në këmbë. Kur ia largojmë dhimbjen, kalon sikur nuk Na ishte lutur fare për dhimbjen që e kishte prekur. Ne kështu ua zbukurojmë shkelësve punët që ata bëjnë.

وَإِذَا مَسَّ الْإِنْسَانَ الضُّرُّ دَعَانَا لِجَنبِهِ أَوْ قَاعِدًا أَوْ قَائِمًا فَلَمَّا كَشَفْنَا عَنْهُ ضُرَّهُ مَرَّ كَأَن لَّمْ يَدْعُنَا إِلَىٰ ضُرِّ مَسَّهُ ۗ كَذٰلِكَ زَيَّنَّا لِّلْمُسْرِفِيْنَ مَا كَانُوْا يَعْمَلُوْنَ ﴿١٣﴾

14. Edhe para jush shkatërruam (njerëz) të kohëve të kaluara kur ata bënë të këqija, dhe atyre u erdhën të Dërguarit e tyre me shenjat e qarta, por ata nuk ishin që besonin. Ne kështu e dënojmë popullin fajtor.

وَلَقَدْ اٰهَلَكْنَا الْقُرُوْنَ مِنْ قَبْلِكُمْ لَمَّا ظَلَمُوْا ۗ وَجَاءَتْهُمْ رُسُلُهُمْ بِالْبَيِّنٰتِ وَمَا كَانُوْا لِيُؤْمِنُوْا ۗ كَذٰلِكَ نَجْزِي الْقَوْمَ الْمُجْرِمِيْنَ ﴿١٤﴾

15. Pas tyre ju kemi vënë ju mëkëmbës në tokë, që të shohim se si do të veproni.<sup>3</sup>

ثُمَّ جَعَلْنَاكُمْ خَلَائِفَ فِي الْاَرْضِ مِنْۢ بَعْدِهِمْ لِنَنْظُرَ كَيْفَ تَعْمَلُوْنَ ﴿١٥﴾

3. Sipas Kuranit të Shenjtë, *umeti* i Muhammedit<sup>savs</sup> është i ngjashëm me *umetin* e Musait<sup>as</sup> (73:16). Siç pohon në një ajet tjetër për *umetin* e Musait<sup>as</sup> “do t’ju bëjë trashëgimtarë në tokë dhe më pas të shohë se si do të veproni ju” (7:130), ky ajet me të njëjtat fjalë i drejtohet *umetit* të Muhammedit<sup>savs</sup>. I Dërguari i Allahut<sup>savs</sup>, duke iu drejtuar muslimanëve tha – “Ju do të

16. Kur atyre u recitohen ajetet Tona të qarta, ata që nuk shpresojnë takimin me Ne, thonë: “Sill ndonjë Kuran tjetër ose ndryshoje këtë”. Thuaj: Nuk kam të drejtë ta ndryshojë këtë nga vetja; unë e ndjek vetëm atë që më shpallet; nëse bëhem i pabindur ndaj Zotit tim, kam frikë nga ndëshkimi i një dite të madhe.

وَإِذَا تُلِيٰ عَلَيْهِمْ آيَاتُنَا بِيِّنَاتٍ ۖ قَالَ الَّذِينَ لَا يَرْجُونَ لِقَاءَنَا إِنَّا بِقُرْآنٍ غَيْرِ هَذَا أَوْ بَدَّلَهُ ۗ قُلْ مَا يَكُونُ لِيَّ أَنْ أَبَدِّلَهُ مِنْ تِلْقَائِي نَفْسِي ۚ إِنْ أَتَّبِعُ إِلَّا مَا يُوحَىٰ إِلَيَّ ۚ إِنِّي أَخَافُ إِنْ عَصَيْتُ رَبِّي عَذَابَ يَوْمٍ عَظِيمٍ ۝١٦

17. Thuaj: Po të donte Allahu, nuk do t’jua recitoja dhe as Ai nuk do t’ju njoftonte për këtë. Sigurisht, jetova një jetë të gjatë mes jush edhe përpara këtij (mesazhi), pra, a nuk kuptoni?!<sup>4</sup>

قُلْ لَوْ شَاءَ اللَّهُ مَا تَلَوْتُهُ عَلَيْكُمْ وَلَا أَدْرِكُمْ بِهِ ۖ فَقَدْ لَبِثْتُ فِيكُمْ عُمُرًا مِّن قَبْلِهِ ۗ أَفَلَا تَعْقِلُونَ ۝١٧

18. Ndaj, kush mund të jetë më keqbërës se ai që trillon gënjeshtër mbi Allahun, ose se ai që i quajti gënjeshtër ajetet e Tij?! Sigurisht,

فَمَنْ أَظْلَمُ مِمَّنِ افْتَرَىٰ عَلَى اللَّهِ كَذِبًا

ndiqni popujt e mëparshëm hap pas hapi; nëse ata do të kenë hyrë në vrimën e zhapikut, edhe ju do të hyni në të. Sahabët e pyetën – O i Dërguari i Allahut, me popujt e mëparshëm, e ke fjalën për hebrejët dhe të krishterët? – Kush tjetër?! iu përgjigj i Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> (Buhari, nr. 3456). Andaj, në suren El-Fatiha, Zoti na mësoi lutjen të mos bëhemi si ata që tërhoqën zemërimin e Zotit. Kush janë këta? Profeti<sup>savs</sup> tha se janë hebrejët. Pse hebrejët? Sepse ata morën mallkimin e *Hazret Isait* duke e refuzuar, sharë dhe persekutuar. Tani, për sa kohë që vetë Zoti na mëson lutjen të mos bëhemi sikur hebrejët, do të thotë se edhe në *umetin* e Muhammedit<sup>savs</sup> do të vinte një Isa, që të plotësohej ngjashmëria e këtij *umeti* me *umetin* e Musait<sup>as</sup>, dhe do të kishte fatligë, të cilët do ta refuzonin Isain e Premtuar. Lexoni edhe shpjegimin e sures El-Fatiha.

4. Idhujtarët e Mekës akuzonin Profetin Muhammed<sup>savs</sup> se ai vetë e sajoi Kuranin e Shenjtë, duke trilluar mbi Allahun, *ma’adhallah*. Ajeti parashtron një kriter të pagabueshëm për të testuar të vërtetën e një pretenduesi të profetërisë. Ai që deklaron të jetë Profet, nëse jeta e tij përpara kësaj deklarate është e pakontestueshme dhe tregon një standard jashtëzakonisht të lartë të vërtetësisë dhe të sinqeritetit, atëherë pretendimi i tij për profetërinë duhet pranuar dhe nuk duhet shpërfillur, sepse ai që nuk ka gënjeshtër në marrëdhëniet e tij me njerëzit, nuk mund të gënjejë dot as në emër të Zotit. Natyrisht, karakteri i njeriut ndërtohet për një kohë të gjatë. Profeti Muhammed<sup>savs</sup> përpara se të zgjidhej si Profet prej Zotit, në gjithë shoqërinë e tij vlerësohej si *i besueshmi* dhe *i vërteti* (*el-emin*; *es-suduk*), atëherë nuk mundej që ai papritmas të kthehej në gënjeshtar.



fajtorët kurrë nuk gëzojnë sukses.

19. Adhurojnë dikë tjetër përveç Allahut, që as nuk u shkakton dot dëm e as dobi dhe thonë: “Këta janë ndërmjetësit tanë pranë Allahut.” Thuaj: A e njoftoni Allahun për diçka që Ai nuk e di as në qiej e as në tokë?! I Lartësuar është Ai dhe i pastër nga gjithçka që e bëjnë ortak me Të.

20. Njerëzit ishin një popull i vetëm, më pas ata ranë në kundërshti. Po të mos ishte lëshuar vendimi (për caktimin e tyre), do të ishte vendosur mes tyre për atë që ata kundërshtojnë njëri-tjetrin.<sup>5</sup>

21. Thonë se përse nuk i zbret ndonjë shenjë prej Zotit të Tij? Atëherë thuaj: E padukshmja është vetëm e Allahut, andaj, prisni, edhe unë po pres bashkë me ju.

22. Kur i bëjmë njerëzit të shijojnë mëshirën, pas dhimbjes që i prek ata, menjëherë bëjnë dredhi me shenjat Tona. Thuaj: Allahu është më i shpejti në strategji; sigurisht, të dërguarit (engjëjt) Tanë e shkruajnë strategjinë tuaj.

23. Është Ai që ju bën të lëvizni në tokë e në det; kur gjendeni nëpër anije, ato lundrojnë nëpërmjet erërave të mira, duke i mbartur (njerëzit) dhe ata gëzohen nga kjo, ndërkohë vjen një erë e tërbuar dhe nga çdo anë i

أَوْ كَذَّبَ بِآيَاتِهِ ۗ إِنَّهُ لَا يُفْلِحُ الْمُجْرِمُونَ ﴿١٠﴾  
وَيَعْبُدُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ مَا لَا يَضُرُّهُمْ  
وَلَا يَنْفَعُهُمْ وَيَقُولُونَ هَؤُلَاءِ شُفَعَاؤُنَا  
عِنْدَ اللَّهِ ۗ قُلْ أَتَسْتَبِئُونَ اللَّهَ بِمَا لَا يَعْلَمُ  
فِي السَّمَوَاتِ وَلَا فِي الْأَرْضِ ۗ سُبْحٰنَهُ وَتَعَالَى  
عَمَّا يُشْرِكُونَ ﴿١١﴾

وَمَا كَانَ النَّاسُ إِلَّا أُمَّةً وَاحِدَةً  
فَاخْتَلَفُوا ۗ وَلَوْلَا كَلِمَةٌ سَبَقَتْ مِنْ رَبِّكَ  
لَقُضِيَ بَيْنَهُمْ فِيمَا فِيهِ يَخْتَلِفُونَ ﴿١٠﴾

وَيَقُولُونَ لَوْلَا أُنزِلَ عَلَيْهِ آيَةٌ مِنْ  
رَبِّهِ ۗ قُلْ إِنَّمَا الْعَيْبُ لِلَّهِ فَانظُرُوا ۗ  
إِنِّي مَعَكُمْ مِنَ الْمُنْتَظِرِينَ ﴿١١﴾

وَإِذَا أَذَقْنَا النَّاسَ رَحْمَةً مِنْ بَعْدِ ضَرَاءٍ  
مَسَّتْهُمْ إِذَا لَهُمْ مَكْرٌ فِي آيَاتِنَا ۗ قُلِ  
اللَّهُ أَسْرَعُ مَكْرًا ۗ إِنَّ رُسُلَنَا يَكْتُبُونَ مَا  
تَمْكُرُونَ ﴿١٢﴾

هُوَ الَّذِي يُسَيِّرُكُمْ فِي الْبَرِّ وَالْبَحْرِ ۗ  
حَتَّىٰ إِذَا كُنْتُمْ فِي الْفُلِكِ ۗ وَجَرَيْنَ بِهِمْ  
بِرِيحٍ طَوَّيْتَهُ وَفَرِحُوا بِهَا جَاءَتْهَا رِيحٌ  
عَاصِفٌ وَجَاءَهُمُ الْمَوْجُ مِنْ كُلِّ مَكَانٍ

5. Premtimi u referohet fjalëve të Zotit “mëshira Ime përfshin çdo gjë” (7:157).

përfshin dallga, dhe kur ata binden se ajo i ka rrethuar, i luten Allahut duke qenë të sinqertë në besimin ndaj Tij: “Nëse na shpëton nga kjo, patjetër do të jemi mirënjohës!”

24. E kur Ai i shpëton, menjëherë rebelohen në tokë, pa të drejtë. O njerëz! Rebelimi juaj është vetëm kundër vetes suaj! Keni përfitim të shkurtër të jetës së kësaj bote, më pas te Ne do të jetë kthimi juaj. Atëherë do t’jua tregojmë ato që bënit.

25. Pa dyshim, shembulli i jetës së kësaj bote është si i ujit që e zbritëm prej qiellit, me të cilin u përzejë bimësia e tokës, që hanë njerëzit e shtazët; kur toka merr stolitë e saj, zbukurohet dhe banorët e saj binden se janë të plotfuqishëm mbi të, atëherë vjen vendimi Ynë gjatë ditës ose gjatë natës, dhe Ne e bëjmë atë si të korrur (përpara se të jepte frutën e vet), sikur ajo nuk ka ekzistuar deri dje. Kështu i shpjegojmë shenjat për njerëzit që meditojnë.<sup>6</sup>

26. Allahu ju thërret drejt shtëpisë së paqes dhe udhëzon kë të dojë drejt rrugës së drejtë.

27. Ata që bënë mirësi, më të mirën do ta kenë, dhe edhe më shumë. Fytyrat e tyre nuk do t’i mbulojnë tymi dhe poshtërimi. Pikërisht këta janë banorët e xhenetit. Ata në të do të jetojnë përgjithmonë.

وَظُنُّوا أَنَّهُمُ أَحْيَطُ بِهِمْ ۗ دَعَا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ ۗ لَئِنِ أَحْيَيْنَا مِنْ هَٰذِهِ لَنَكُونَنَّ مِنَ الشَّاكِرِينَ ﴿١٧﴾

فَلَمَّا أَجَاهُمْ إِذَا هُمُ يَبْعُونَ فِي الْأَرْضِ بِغَيْرِ الْحَقِّ يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنَّمَا بَعَيْتُمْ عَلَىٰ أَنْفُسِكُمْ ۗ مَتَاعَ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا ۗ ثُمَّ إِلَيْنَا مَرْجِعُكُمْ فَنُنَبِّئُكُمْ بِمَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ ﴿١٨﴾

إِنَّمَا مَثَلُ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا كَمَاءٍ أَنْزَلْنَاهُ مِنَ السَّمَاءِ فَاخْتَلَطَ بِهِ نَبَاتُ الْأَرْضِ مِمَّا يَأْكُلُ النَّاسُ وَالْأَنْعَامُ ۗ حَتَّىٰ إِذَا أَخَذَتِ الْأَرْضُ زُخْرُفَهَا وَازَّيَّنَتْ وَظَنَّ أَهْلُهَا أَنَّهُمْ قَدِرُوا عَلَيْهِهَا ۗ أَتَاهَا أَمْرًا لَيْلًا أَوْ نَهَارًا فَجَعَلْنَاهَا حَصِيدًا كَأَن لَّمْ تَعْنِ بِالْأَمْسِ ۗ كَذَٰلِكَ نَفْصَلُ الْآيَاتِ لِقَوْمٍ يُفَكِّرُونَ ﴿١٩﴾

وَاللَّهُ يَدْعُو إِلَىٰ دَارِ السَّلَامِ ۗ وَيَهْدِي مَنْ يَشَاءُ إِلَىٰ صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ ﴿٢٠﴾

لِلَّذِينَ أَحْسَنُوا الْحُسْنَىٰ وَزِيَادَةٌ ۗ وَلَا يَرْهَقُ وُجُوهَهُمْ قَتَرٌ وَلَا ذِلَّةٌ ۗ أُولَٰئِكَ أَصْحَابُ الْجَنَّةِ ۗ هُمْ فِيهَا خَالِدُونَ ﴿٢١﴾

6. Kur kombet bëhen mendjemëdha dhe përfshihen në kotësi duke e marrë jetën si diçka të parëndësishme, fillon rënia e tyre dhe më pas ato dëshpërohen. Lexoni edhe 57:21-22.

28. Dhe (për) ata që korrën të këqijta, dënimi i së keqes do të jetë sa e keqja. Ata do t'i zërë poshtërimi. Nuk do të kenë asnjë shpëtimtar përveç Allahut. Fytyrat e tyre do të jenë sikur i ka pushtuar një copë e natës me errësirë. Pikërisht këta janë banorët e zjarrit. Ata në të do të mbesin gjatë.<sup>7</sup>

وَالَّذِينَ كَسَبُوا السَّيِّئَاتِ جَزَاءُ سَيِّئَةٍ  
بِمِثْلِهَا وَتَرْهَقُهُمْ ذِلَّةٌ ۗ مَا لَهُمْ مِنَ اللَّهِ  
مِنْ عَاصِمٍ ۚ كَانَمَا أَغْشِيَتْ وُجُوهُهُمْ  
قِطْعًا مِّنَ اللَّيْلِ مُظْلِمًا ۗ أُولَٰئِكَ أَصْحَابُ  
النَّارِ ۗ هُمْ فِيهَا خَالِدُونَ ﴿٢٨﴾

29. Ditën kur do t'i tubojmë të gjithë, e do t'u themi atyre që adhuronin dikë tjetër përveç Zotit: Qëndroni në vend, ju dhe të adhuruarit tuaj! Më pas, do të vëmë ndarje mes tyre, kurse të adhuruarit e tyre do të thonë: “Ju nuk na adhuronit ne,

وَيَوْمَ نَحْشُرُهُمْ جَمِيعًا ثُمَّ نَقُولُ لِلَّذِينَ  
أَشْرَكُوا مَكَانَكُمْ أَنْتُمْ وَشُرَكَائِكُمْ ۚ  
فَزَيْلَانَا بَيْنَهُمْ وَقَالَ شُرَكَائُهُمْ مَا كُنْتُمْ  
إِلَّآنَا تَعْبُدُونَ ﴿٢٩﴾

30. ndaj, (na) mjafton Allahu si Dëshmitar mes nesh e jush, sigurisht, kemi qenë të pavetëdijshëm për adhurimin tuaj.”

فَكَفَى بِاللَّهِ شَهِيدًا بَيْنَنَا وَبَيْنَكُمْ إِنْ كُنَّا  
عَن عِبَادَتِكُمْ لَغْفِيلِينَ ﴿٣٠﴾

31. Atje çdo shpirt do të mësojë se çfarë ka bërë në të kaluarën dhe ata do të kthehen tek Allahu, Zoti i tyre i vërtetë, dhe do t'u humbet gjithçka që ata trillonin.

هُنَالِكَ تَبْلُغُوا كُلُّ نَفْسٍ مَّا أَسْلَفَتْ  
وَرُدُّوْا إِلَى اللَّهِ مَوْلَاهُمْ الْحَقِّ وَصَلَّ  
لَهُمْ عَنهُمْ مَّا كَانُوا يَفْتَرُونَ ﴿٣١﴾

32. Thuaj: Kush ju ushqen prej qiellit dhe tokës?! Ose kush është që sundon dëgjimin dhe shikimin?! Kush nxjerr të gjallin prej të vdekurit

قُلْ مَنْ يَرْزُقُكُمْ مِّنَ السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ  
أَمْ مَنْ يَمْلِكُ السَّمْعَ وَالْأَبْصَارَ وَمَنْ  
يُخْرِجُ الْحَيَّ مِنَ الْمَيِّتِ وَيُخْرِجُ الْمَيِّتِ

7. Ajeti tregon disa të vërteta të rëndësishme: (1) Ndërsa shpërblimi i së mirës është i shumëfishtë (10:27), dënimi i së keqes është aq sa është e keqja. (2) Ata që thejnë ligjet e Zotit, nuk mund të kenë frymëzim për idealet e larta dhe nuk mund të kenë motiv fisnik në jetën e tyre dhe bëhen thjesht imitues të të tjerëve, duke humbur çdo iniciativë dhe aftësinë për të qenë udhëheqës të njerëzve. (3) Me një jetë të tillë, ata humbasin ndihmën e Zotit. (4) Paudhësitë dhe shkeljet e keqbërësve nuk mund të jenë të fshehura për një kohë të gjatë, por do të zbulohen herët a vonë.

dhe të vdekurin prej të gjallit?! Dhe kush e drejton çështjen?! Ata do të thonë: “Allahu.” Atëherë thuaj: A nuk (i) druheni?!

33. Pra, Ai është Allahu, Zoti juaj i Vërtetë. E çfarë mbetet pas së vërtetës, përveç humbjes?! Atëherë ku po largoheni?!

34. Kështu plotësohet fjala e Zotit tënd për ata që janë të pabindshëm, se ata nuk kanë për të besuar kurrë.

35. Pyeti: A ka ndonjë nga zotat tuaj që nis krijimin, edhe e përsërit atë?! Thuaj: Allahu e nis krijimin, edhe e përsërit atë. Atëherë ku po përumbeni?!

36. Pyeti: A ka ndonjë nga zotat tuaj që udhëzon drejt së vërtetës?! Thuaj: Allahu udhëzon drejt së vërtetës. Atëherë, cili meriton më shumë të ndiqet, ai që udhëzon drejt së vërtetës apo ai që nuk udhëzohet, përveçse nëse i jepet udhëzimi?! Atëherë, çfarë ju ndodhi (e) si gjykoni?!

37. Shumica e tyre ndjekin veç hamendjen. Pa dyshim, hamendja nuk e zëvendëson asnjë fije të vërtetën. Sigurisht, Allahu është i Gjithëdijshëm për atë që bëjnë.

38. Ky Kuran nuk është i tillë që, duke u veçuar nga Allahu, (thjesht) të mund të trillohej, përkundrazi, është vërtetuesi i asaj që e ka përpara dhe është shpjeguesi i Librit, në të cilin

مَنْ الْحَيِّ وَمَنْ يُدِيرُ الْأَمْرَ ۗ فَسَيَقُولُونَ  
اللَّهُ ۗ قُلْ أَفَلَا تَتَّقُونَ ﴿٣١﴾

فَذَلِكُمْ اللَّهُ رَبُّكُمُ الْحَقُّ ۗ فَمَاذَا بَعَدَ  
الْحَقِّ إِلَّا الضَّلَالُ ۗ فَأَلَىٰ تَصْرَفُونَ ﴿٣٢﴾

كَذَلِكَ حَقَّتْ كَلِمَتُ رَبِّكَ عَلَى الَّذِينَ  
فَسَقَوْا أَنَّهُمْ لَا يُؤْمِنُونَ ﴿٣٣﴾

قُلْ هَلْ مِنْ شُرَكَائِكُمْ مَنْ يَبْدُوا الْخَلْقَ  
ثُمَّ يُعِيدُهُ ۗ قُلِ اللَّهُ يَبْدُوا الْخَلْقَ ثُمَّ  
يُعِيدُهُ ۗ فَأَلَىٰ تَوَفُّوْنَ ﴿٣٤﴾

قُلْ هَلْ مِنْ شُرَكَائِكُمْ مَنْ يَهْدِي إِلَى  
الْحَقِّ ۗ قُلِ اللَّهُ يَهْدِي لِلْحَقِّ ۗ أَفَمَنْ  
يَهْدِي إِلَى الْحَقِّ أَحَقُّ أَنْ يُتَّبَعَ أَمْ  
لَا يَهْدِي إِلَّا أَنْ يُهْدَىٰ ۗ فَمَا لَكُمْ كَيْفَ  
تَحْكُمُونَ ﴿٣٥﴾

وَمَا يَتَّبِعْ أَكْثَرُهُمْ إِلَّا ظَنًّا ۗ إِنَّ الظَّنَّ  
لَا يُغْنِي مِنَ الْحَقِّ شَيْئًا ۗ إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ بِمَا  
يَفْعَلُونَ ﴿٣٦﴾

وَمَا كَانَ هَذَا الْقُرْآنُ أَنْ يُفْتَرَىٰ مِنْ دُونِ  
اللَّهِ وَلَكِنْ تَصَدِيقُ الَّذِي بَيْنَ يَدَيْهِ  
وَتَفْصِيلَ الْكِتَابِ لَا رَيْبَ فِيهِ مِنْ رَبِّ

nuk ka mëdyshje; është prej Zotit të botëve.<sup>8</sup>

39. A thonë se ai e ka trilluar këtë?!  
Thuj: Sillni pra një sure të ngjashme me të tijën dhe thirrni kë të mundeni përveç Allahut, nëse thoni të vërtetën.

40. Në të vërtetë, ata quajtën gënjeshtër atë që nuk e rrokën për nga dija dhe atyre nuk u erdhi ende shpjegimi i saj. Kështu, (atë e) quajtën gënjeshtër edhe ata që ishin para tyre. Kështu që, shiko se si ka qenë fundi i keqbërësve.

41. Prej tyre ka që e besojnë atë dhe po prej tyre ka edhe nga ata që nuk e besojnë atë. Zoti yt i di më së miri ata që janë ngatërrestarë.

42. Nëse të quajnë gënjeshtar, thuj: Unë kam veprën time dhe ju keni veprën tuaj. Ju nuk keni përgjegjësi për atë që bëj unë dhe unë nuk kam përgjegjësi për atë që bëni ju.

43. Prej tyre ka edhe nga ata që e mbajnë veshin te ti. A mund t'i bësh shurdhët të dëgjojnë, kur ata as nuk kuptojnë?!

8. Ajeti jep pesë arsye bindëse për të treguar se Kurani është Fjala e shpallur e Zotit: (1) Kurani trajton tema të tilla që njeriu vetë nuk mund t'i dinte dhe që mund të zbuloheshin vetëm nga Zoti. (2) Profecitë e Profetëve të mëparshëm përcaktojnë origjinën Hyjnore të Kuranit. (3) Kurani shpjegon mësimet e Shkrimeve të mëparshme Hyjnore në një mënyrë kaq të qartë dhe gjithëpërfshirëse sa nuk e ka bërë asnjë Shkrim tjetër më parë. (4) Ai përmban arsyet dhe argumentet e nevojshme për të gjitha deklaratat që bën, dhe si i tillë, nuk ka asnjë dyshim në të. (5) Ndryshe nga Shkrimet e feve të mëparshme, Kurani plotëson nevojat dhe kërkesat morale e shpirtërore të gjithë njerëzimit për të gjitha kohërat.

الْعَالَمِينَ ﴿١١﴾

أَمْ يَقُولُونَ افْتَرَاهُ ۗ قُلْ فَأْتُوا بِسُورَةٍ مِّثْلِهِ وَادْعُوا مَنِ اسْتَضَعْتُمْ مِنْ دُونِ اللَّهِ إِنْ كُنْتُمْ صَادِقِينَ ﴿١١﴾

بَلْ كَذَّبُوا بِمَا لَمْ يُحِصُوا بِعِلْمِهِ وَلَمَّا يَأْتِهِمْ تَأْوِيلُهُ ۗ كَذَلِكَ كَذَّبَ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ فَانظُرْ كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ الظَّالِمِينَ ﴿١١﴾

وَمِنْهُمْ مَنْ يُؤْمِنُ بِهِ وَمِنْهُمْ مَنْ لَا يُؤْمِنُ بِهِ ۗ وَرَبُّكَ أَعْلَمُ بِالْمُفْسِدِينَ ﴿١١﴾

وَإِنْ كَذَّبُوكَ فَقُلْ إِنِّي عَمَلِي وَلَكُمْ عَمَلُكُمْ ۗ أَنْتُمْ بَرِيئُونَ مِمَّا أَعْمَلُ وَأَنَا بَرِيءٌ مِمَّا تَعْمَلُونَ ﴿١١﴾

وَمِنْهُمْ مَنْ يَسْتَمِعُونَ إِلَيْكَ ۗ أَفَأَنْتَ تَسْمِعُ الصُّمَّ وَلَوْ كَانُوا لَا يَعْقِلُونَ ﴿١١﴾

44. Prej tyre ka edhe nga ata që të shohin ty. A mund të udhëzosh të verbrit, kur ata as nuk perceptojnë.

وَمِنْهُمْ مَّن يَنْظُرُ إِلَيْكَ أَفَأَنْتَ تَهْدِي  
الْعُمَىٰ وَلَوْ كَانُوا لَا يَبْصُرُونَ ﴿٤٤﴾

45. Sigurisht, Allahu nuk u bën keq njerëzve aspak, por njerëzit i bëjnë keq vetvetes.

إِنَّ اللَّهَ لَا يَظْلِمُ الْبَاطِلَ شَيْئًا وَ لَكِنَّ  
الْبَاطِلَ أَنفُسَهُمْ يَظْلِمُونَ ﴿٤٥﴾

46. Ditën kur Ai do t'i tubojë ata, do të ndiejnë sikur nuk kanë qëndruar (në tokë) përveçse një orë të ditës. Do të njihen me njëri-tjetrin. Do të jenë në humbje të sigurt ata që mohuan takimin me Allahun dhe që nuk e morën udhëzimin.

وَيَوْمَ يُحْشَرُهُمْ كَأَن لَّمْ يَلْبَسُوا إِلَّا سَاعَةً  
مِّنَ النَّهَارِ يَتَعَارَفُونَ بَيْنَهُمْ ۗ قَدْ حَسِرَ  
الَّذِينَ كَذَّبُوا بِلِقَاءِ اللَّهِ وَمَا كَانُوا  
مُهْتَدِينَ ﴿٤٦﴾

47. Në të tregofshim disa nga ato që ua kemi premtuar (nga paralajmërimet), a në të dhënçim vdekjen, (gjithsesi) te Ne është kthimi i tyre. Më pas, Allahu është Dëshmitar mbi atë që bëjnë.<sup>9</sup>

وَأَمَّا نُرِّيكَ بَعْضَ الَّذِي نَعِدُهُمْ أَوْ  
تَتَوَقَّيْتُكَ فَإِنَّا مَرْجِعُهُمْ ثُمَّ اللَّهُ شَهِيدٌ  
عَلَىٰ مَا يَفْعَلُونَ ﴿٤٧﴾

48. Çdo popull ka një të dërguar. Kur u vjen i Dërguari i tyre, vendoset me drejtësi mes tyre dhe atyre nuk u bëhet padrejtësi.

وَلِكُلِّ أُمَّةٍ رَّسُولٌ ۚ فَإِذَا جَاءَ رَسُولُهُمْ  
قَضَىٰ بَيْنَهُمْ بِالْقِسْطِ ۚ وَهُمْ لَا يُظْلَمُونَ ﴿٤٨﴾

49. Ata pyesin: “Kur do të përmbushet ky premtim, nëse qëndroni mbi të vërtetën?”

وَيَقُولُونَ مَتَىٰ هَذَا الْوَعْدِ إِن كُنتُمْ  
صَادِقِينَ ﴿٤٩﴾

50. Thuaj: Nuk kam fuqi t'i sjell vetes as dëm e as dobi, përveç asaj

قُلْ لَا أَمْلِكُ لِنَفْسِي ضَرًّا وَلَا نَفْعًا إِلَّا  
مَا شَاءَ اللَّهُ ۗ لِكُلِّ أُمَّةٍ أَجَلٌ ۗ إِذَا جَاءَ

9. Ky ajet tregon se nuk është e domosdoshme që të gjitha parashikimet të përmbushen gjatë jetës së Profetit. Po, disa prej tyre përmbushen gjatë jetës së tij. Kurani i Shenjtë që iu zbrit Profetit Muhammed<sup>saws</sup>, solli profeci të shumta. Disa prej tyre u përmbushën gjatë jetës së tij, disa pas vdekjes së tij, disa të tjera vijnë të përmbushen edhe sot e gjithë ditën dhe kështu do të vijnë deri në kiamet.

që do Allahu. Për çdo popull ka një afat. Kur u vjen afati, ata nuk mund të vonohen asnjë çast e as nuk mund ta parakalojnë.

51. Thuaj: Nëse ju vjen ndëshkimi i Tij gjatë natës, ose gjatë ditës, fajtorët si mund të ikin prej tij?!

52. A do ta besoni atëherë kur do të ketë ndodhur?! (A mund të keni rrugëdalje) tani, kurse këtë e kërkonit të vinte më shpejt?!

53. Pastaj, do t'u thuhet atyre që bënë padrejtësi: Shijoni ndëshkimin e vazhdueshëm! A po ndëshkoheni për ndonjë gjë tjetër nga ajo që keni punuar?!

54. Ata të pyesin ty: "Vërtet do të ndodhë kjo?" Thuaj: Sigurisht, për Zotin tim, ajo do të ndodhë me të vërtetë dhe ju nuk mund ta ndalni (atë).

55. Çdo shpirt që bëri padrejtësi, edhe sikur të kishte gjithçka që ka toka, do ta jepte si shpagim. Do ta fshehin pendesën kur do të shohin ndëshkimin. Do të vendoset me drejtësi mes tyre, dhe atyre nuk do t'u bëhet padrejtësi.

56. Dijeni! E Allahut është gjithçka që gjendet në qiej e në tokë. Dijeni! Premtimi i Allahut është i vërtetë, por shumica e tyre nuk e dinë.

أَجَلُهُمْ فَلَا يَسْتَأْخِرُونَ سَاعَةً وَلَا يَسْتَقْدِمُونَ ﴿٥١﴾

قُلْ أَرَأَيْتُمْ إِنْ أَتَاكُمْ عَذَابُهُ بَيَاتًا أَوْ نَهَارًا مَّاذَا يَسْتَعْجِلُ مِنْهُ الْمُجْرِمُونَ ﴿٥٢﴾

أَنْتُمْ إِذَا مَا وَقَعَ أَنْتُمْ بِهِ الْآنَ وَقَدْ كُنْتُمْ بِهِ تَسْتَعْجِلُونَ ﴿٥٣﴾

ثُمَّ قِيلَ لِلَّذِينَ ظَلَمُوا ذُوقُوا عَذَابَ الْخُلْدِ هَلْ تُجْرُونَ إِلَّا بِمَا كُنْتُمْ تَكْسِبُونَ ﴿٥٤﴾

وَيَسْتَسئِبُونَكَ أَحَقُّ هُوَ قُلْ إِي وَرَبِّي إِنَّهُ عَزِيزٌ حَقِيقٌ ﴿٥٥﴾ وَمَا أَنْتُمْ بِمُعْجِزِينَ ﴿٥٦﴾

وَلَوْ أَنَّ لِكُلِّ نَفْسٍ ظَلَمَتْ مَا فِي الْأَرْضِ لَافْتَدَتْ بِهِ وَأَسْرُوا النَّدَامَةَ لَمَّا رَأَوُا الْعَذَابَ وَقُضِيَ بَيْنَهُم بِالْقِسْطِ وَهُمْ لَا يُظْلَمُونَ ﴿٥٧﴾

إِلَّا إِنْ لِلَّهِ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ إِلَّا إِنْ وَعَدَ اللَّهُ حَقٌّ وَلَكِنْ أَكْثَرُهُمْ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٥٨﴾

57. Ai jep jetë dhe shkakton vdekje dhe tek Ai do të ktheheni.

هُوَ يُحْيِي وَيُمِيتُ وَإِلَيْهِ تُرْجَعُونَ ﴿٥٧﴾

58. O njerëz! Juve ju ka ardhur një këshillë prej Zotit tuaj, shërim për atë (sëmundje) që keni në kraharrorë, udhëzim, si dhe mëshirë për besimtarët.<sup>10</sup>

يَا أَيُّهَا النَّاسُ قَدْ جَاءَ تَكْمٌ مَّوْعِظَةٌ مِّن رَّبِّكُمْ وَشِفَاءٌ لِّمَا فِي الصُّدُورِ ۗ وَهُدًى وَرَحْمَةً لِّلْمُؤْمِنِينَ ﴿٥٨﴾

59. Thuaj: (Kjo është) me bekimin e Allahut dhe me mëshirën e Tij, ndaj, ata le të gëzohen për këtë. Kjo është më e mirë se ajo çfarë ata e grumbullojnë.

قُلْ بِفَضْلِ اللَّهِ وَبِرَحْمَتِهِ فَبِذَلِكَ فَلْيَفْرَحُوا ۗ هُوَ خَيْرٌ مِّمَّا يَجْمَعُونَ ﴿٥٩﴾

60. Pyeti: A nuk shikoni se ajo që Allahu ju ka zbritur si ushqim, ju vetë e keni bërë një pjesë të ndaluar, e një pjesë të lejuar?! Pyeti: Allahu jua ka lejuar këtë apo trilloni mbi Allahun?!

قُلْ أَرَأَيْتُمْ مَا أَنْزَلَ اللَّهُ لَكُمْ مِّن رِّزْقٍ فَجَعَلْتُم مِّنْهُ حَرَامًا وَحَلَالًا قُلْ اللَّهُ أَذِنَ لَكُمْ أَمْ عَلَى اللَّهِ تَفْتَرُونَ ﴿٦٠﴾

61. E çfarë do të mendojnë Ditën e Kiametit ata që trillojnë gënjeshtër mbi Allahun?! Në të vërtetë, Allahu u jep shumë bekime njerëzve, por shumica e tyre nuk falënderojnë.

وَمَا ظَنُّ الَّذِينَ يَفْتَرُونَ عَلَى اللَّهِ الْكَذِبَ يَوْمَ الْقِيَامَةِ ۗ إِنَّ اللَّهَ لَذُو فَضْلٍ عَلَى النَّاسِ وَلَٰكِنَّ أَكْثَرَهُمْ لَا يَشْكُرُونَ ﴿٦١﴾

62. Dhe ti çdo herë që përjeton diçka, çdo herë që reciton diçka nga Kurani në atë (përjetim), dhe (ju o besimtarë!) çdo vepër (të mirë) që bëni, Ne jemi Dëshmitar mbi ju, kur ju jeni të angazhuar në të. Asgjë qoftë sa një grimcë nuk fshihet nga Zoti yt, as në tokë e as në qiell; dhe nuk

وَمَا تَكُونُ فِي شَأْنٍ وَمَا تَتْلُوا مِنْهُ مِنْ قُرْآنٍ وَلَا تَعْمَلُونَ مِنْ عَمَلٍ إِلَّا كُنَّا عَلَيْكُمْ شُهُودًا إِذْ تُفِيضُونَ فِيهِ ۗ وَمَا يَعْزُبُ عَنْ رَبِّكَ مِنْ مِثْقَالِ ذَرَّةٍ فِي الْأَرْضِ وَلَا فِي السَّمَاءِ وَلَا أَصْغَرَ

10. Kurani është shërim për sëmundjet. Për këtë arsye, ai nuk mund të quhet thjesht një libër me informacion, i përcjellë përgjatë brezash, por është i mbushur me argumente të arsyeshme të një shkalle të lartë me një dritë të qartë.



ka as ndonjë gjë tjetër më të vogël se ajo e as më të madhe, përveçse është (shënuar) në një Libër të hapur.

63. Dijeni! Miqtë e Allahut nuk do të kenë as frikë e as nuk do të pikëllohen;<sup>11</sup>

64. të cilët besuan dhe patën druajtje (ndaj Allahut).<sup>12</sup>

65. Ata do të kenë lajmin e mirë në këtë botë dhe në *ahiret*. Nuk ka ndryshim në fjalët e Allahut. Ky pikërisht është sukcesi madhor.<sup>13</sup>

66. Le të mos të brengosë ty fjala e tyre. Pa dyshim, nderi i gjithi është i Allahut. Ai është Gjithëdëgjuesi, i Gjithëdijshmi.

67. Dijeni! Është i Allahut kushdo që është në qiej e në tokë. Ata që adhurojnë dikë tjetër veç Allahut,

مَنْ ذَلِكَ وَلَا أَكْبَرَ إِلَّا فِي كِتَابٍ مُّبِينٍ ﴿١١﴾

إِلَّا إِنَّ أَوْلِيَاءَ اللَّهِ لَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ  
وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ ﴿١٢﴾

الَّذِينَ آمَنُوا وَكَانُوا يَتَّقُونَ ﴿١٣﴾

لَهُمُ الْبُشْرَىٰ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَفِي الْآخِرَةِ ۗ  
لَا تَبْدِيلَ لِكَلِمَاتِ اللَّهِ ۗ ذَلِكَ هُوَ الْفَوْزُ  
الْعَظِيمُ ﴿١٤﴾

وَلَا يَحْزَنُكَ قَوْلُهُمْ ۗ إِنَّ الْعِزَّةَ لِلَّهِ جَمِيعًا ۗ  
هُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ ﴿١٥﴾

إِلَّا إِنَّ لِلَّهِ مَنْ فِي السَّمَوَاتِ وَمَنْ فِي  
الْأَرْضِ ۗ وَمَا يَتَّبِعُ الَّذِينَ يَدْعُونَ مِنْ

11. Frika lidhet me të ardhmen e njeriut, kurse brenga për veprimet e tij në të kaluarën.

12. Ajetet 63-64: Shenjat e atyre që e duan Zotin me sinqeritet të plotë dhe të cilët edhe Zoti i do, janë që ata nuk kanë frikë për problemet e tyre të kësaj bote, sepse Zoti u dhuron qetësi, dhe po kështu, edhe për të kaluarën ata nuk kanë ndonjë brengë, sepse Zoti u jep durim. Shenja tjetër është që ata besojnë, pra besojnë në mënyrë të përsosur dhe kanë druajtjen ndaj Zotit, pra, qëndrojnë larg nga çdo gjë që është kundër besimit dhe kundër nënshtrimit ndaj Zotit. Për këtë arsye, ata nuk do të kenë as stres, as frikë.

13. Ajetet 63-65: Kurani i Shenjtë nuk e quan të mbyllur rrugën e komunikimit me Zotin, madje pohon se shpalljet me lajme të mira për besimtarët vijnë, por se shpalljet që sjellin ligje janë ndërprerë, sepse bota ka hyrë në fazën e saj të fundit. Andaj, komunikimi i Zotit në formë lajmesh të mira mbetet deri në kiamet. Premtimi i Allahut për besimtarët e sinqertë si në këtë botë ashtu edhe në tjetrën dhe që kurrësi nuk mund të mbetet i paplotësuar, është: Ai do t'u dhurojë dashurinë dhe pozitën e komunikimit me Të në formë shpalljesh, ëndrrash të vërteta dhe *keshti* (vizioni) njerëzve që ndjekin rrugën e Tij. Këta quhen *evlija* (*veli* në njëjës), miq ose të dashur të Zotit. Shenja e tyre më dalluese se çdo shenjë tjetër është pikërisht komunikimi me Zotin. Lexoni edhe 41:31.

nuk i ndjekin zotat (e tyre), por ndjekin vetëm hamendjen dhe ata nuk punojnë veçse me fiksime.

68. Është Ai që bëri natën për ju, që të qetësoheni në të dhe ditën ndriçuese. Sigurisht, ka shenja në të për njerëzit që dëgjojnë.

69. Thonë: “Allahu mori një bir”. I shenjtë është Ai, i Vetëmjaftueshmi. E Atij është gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në tokë. A keni ndonjë argument për këtë (besim)?! A thoni mbi Allahun diçka që nuk e dini?!<sup>14</sup>

70. Thuaj: Ata që trillojnë gënjeshtër mbi Allahun, kurrresi nuk do të kenë sukses.

71. Një përfitim i shkurtër në këtë botë, më pas te Ne është kthimi i tyre. Pastaj, do t'i bëjmë të shijojnë ndëshkimin e rëndë për shkak se e mohonin (të vërtetën).

72. Lexoju atyre lajmin e Nuhut. Kur ai i tha popullit të vet: “O populli im! Nëse ju vijnë rëndë pozita ime dhe këshillat e mia përmes shenjave të Allahut, tek Allahu mbështetem unë. Andaj, mblidhni forcën dhe ortakët tuaj, le të mos mbetet dyshim në

دُونِ اللَّهِ شُرَكَاءَ ۗ إِنْ يَتَّبِعُونَ إِلَّا الظَّنَّ  
وَإِنْ هُمْ إِلَّا يَخْرُصُونَ ﴿٦٧﴾

هُوَ الَّذِي جَعَلَ لَكُمُ اللَّيْلَ لِتَسْكُنُوا فِيهِ  
وَالنَّهَارَ مُبْصِرًا ۗ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِّقَوْمٍ  
يَسْمَعُونَ ﴿٦٨﴾

قَالُوا اتَّخَذَ اللَّهُ وَلَدًا سُبْحٰنَهُ ۗ هُوَ الْعَزِيزُ  
لَهُ مَا فِي السَّمٰوٰتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ ۗ إِنْ  
عِنْدَكُمْ مِنْ سُلْطٰنٍ بِهٰذَا ۗ اَنْتَقُولُونَ  
عَلَى اللَّهِ مَا لَا تَعْلَمُونَ ﴿٦٩﴾

قُلْ إِنْ الْاٰدِیْنَ یَفْتَرُونَ عَلَى اللَّهِ الْكٰذِبَ  
لَا یُفْلِحُونَ ﴿٧٠﴾

مَتَاعٍ فِی الدُّنْیَا ثُمَّ اٰیِنَا مَرْجِعُهُمْ ثُمَّ  
نُذِیْقُهُمُ الْعَذَابَ الشَّدِیْدَ بِمَا كَانُوْا  
یَكْفُرُوْنَ ﴿٧١﴾

وَاقْلُ عَلَيْهِمْ نَبَا نُوحٍ ۗ اِذْ قَالَ لِقَوْمِهِ یٰقَوْمِ  
اِنْ كَانَ كَبُرَ عَلَیْكُمْ مَّقَامِی وَتَذٰكِرِی  
بَاٰیٰتِ اللّٰهِ فَعَلٰی اللّٰهِ تَوَكَّلْتُ فَاجْمَعُوْا  
اَمْرَكُمْ وَشُرَكَاءَكُمْ ثُمَّ لَا یَكُنْ

14. Duke parashtruar argumentet se përse Zoti nuk ka bir, ajeti pohon: (a) Zoti është i pastër nga çdo e metë, i pastër edhe nga plakja dhe vdekja, dhe për këtë arsye nuk i duhet trashëgimtar, që ai ta vazhdonte punën e Tij. (b) Duke qenë i Vetëmjaftueshëm, Ai nuk ka nevojë për djalë, që ai ta ndihmonte në drejtimin e punëve të universit. (c) Doktrina që Zoti të ketë bir nuk bazohet në asnjë bazë të shëndoshë dhe nuk shkon përtej supozimeve apo hamendjeve boshe.

forcën tuaj dhe më pas bëjeni atë që doni ndaj meje, pa më dhënë asnjë lëshim.<sup>15</sup>

73. Nëse e ktheni shpinën, nuk ju kërkohet ndonjë shpërblim. Shpërblimi im është vetëm tek Allahu. Jam urdhëruar të bëhem ndër të nënshtruarit.<sup>16</sup>

74. Ata e quajtën gënjeshtar. Atëherë Ne e shpëtuan atë dhe bashkudhëtarët e tij në arkë dhe i bëmë mëkëmbës, kurse ata që i quajtën gënjeshtër shpalljet Tona, i fundosëm. Pra, shih se si ishte fundi i të paralajmëruarve.

75. Pas tij ngritëm shumë të dërguar te popujt e tyre, që u erdhën me shenjat e qarta. Por ata nuk ishin që besonin diçka që e kishin quajtur gënjeshtër më parë. Ne kështu ua vulosim zemrat shkelësve.

76. Pas tyre dërguam Musain dhe Harunin me shenjat Tona te Faraoni dhe paria e tij. Ata u treguan

أَمْرُكُمْ عَلَيْكُمْ غَمَّةٌ ثُمَّ اقْضُوا إِلَيَّ  
وَلَا تُنظِرُونَ ﴿١٥﴾

فَإِنْ تَوَيْتُمْ فَمَا سَأَلْتُمْ مِنْ أَجْرٍ ۗ إِنْ  
أَجْرِي إِلَّا عَلَى اللَّهِ ۗ وَأُمِرْتُ أَنْ أَكُونَ  
مِنَ الْمُسْلِمِينَ ﴿١٦﴾

فَكَذَّبُوهُ فَجَبَّيْنَاهُ وَمَنْ مَعَهُ فِي الْفُلِكِ  
وَجَعَلْنَاهُمْ حَافِلِينَ وَأَغْرَقْنَا الَّذِينَ كَذَّبُوا  
بِآيَاتِنَا ۚ فَانظُرْ كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ  
الْمُنذَرِينَ ﴿١٧﴾

ثُمَّ بَعَثْنَا مِنْ بَعْدِهِ رَسُولًا إِلَىٰ قَوْمِهِمْ  
فَجَاءَهُمْ بِالْبَيِّنَاتِ فَمَا كَانُوا لِيُؤْمِنُوا  
بِمَا كَذَّبُوا بِهِ مِنْ قَبْلُ ۗ كَذَلِكَ نَضَعُ عَلَىٰ  
قُلُوبِ الْمُعْتَدِينَ ﴿١٨﴾

ثُمَّ بَعَثْنَا مِنْ بَعْدِهِمُ مُوسَىٰ وَهَارُونَ إِلَىٰ  
فِرْعَوْنَ وَمَلَئِهِ بِآيَاتِنَا فَاسْتَكْبَرُوا وَكَانُوا

15. Një lexim i kujdesshëm i rrëfimeve të tre Profetëve – Nuhut<sup>as</sup>, Musait<sup>as</sup> dhe Junusit<sup>as</sup>, të përmendura në ajetet vijuese tregon se historia e tyre është përsëritur në jetën e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>. Ai luajti rolin e Nuhut në Mekë, atë të Musait në Medinë dhe të Junusit gjatë çlirimit të Mekës. Kjo mjafton për të treguar se rrëfimet e Profetëve të dhëna në Kuran nuk janë thjesht tregime, por përbëjnë profeci të mëdha për ngjarje të rëndësishme që do të ndodhnin në jetën e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>.

16. Një akuzë e zakonshme që ngrenë kundër Profetëve të Zotit, është që ata kërkohet epërsi mbi bashkatdhetarët e tyre duke ngritur një front kundër pushtetit ekzistues, me synimin për të vendosur një rend të ri nën udhëheqjen e vet. Ky ajet e hedh poshtë këtë akuzë duke thënë se Profetët e Zotit kurrë nuk kërkohet shpërblime apo lëvdë. Ata synojnë vetëm pëlqimin e Zotit dhe nënshtrimin ndaj Tij.

mendjemëdhenj dhe ishin një popull fajtor.

قَوْمًا مُّجْرِمِينَ ﴿٧٦﴾

77. E kur u erdhi e vërteta prej Nesh, thanë: “Kjo është magji e hapur!”

فَلَمَّا جَاءَهُمُ الْحَقُّ مِنْ عِنْدِنَا قَالُوا إِنَّ

هَذَا سِحْرٌ مُّبِينٌ ﴿٧٧﴾

78. Musai tha: “I thoni së vërtetës (kështu) kur ajo ju ka ardhur?! Magji është kjo?! E po magjistarët nuk gëzojnë sukses.”

قَالَ مُوسَىٰ أَتَقُولُونَ لِلْحَقِّ لَمَّا جَاءَكُمْ

أَسِحْرٌ هَذَا وَلَا يُفْلِحُ السَّحَرُونَ ﴿٧٨﴾

79. Ata thanë: “A na erdhe që të na largosh nga ajo ku kemi gjetur etërit tanë dhe ju të dy ta keni pozitën në vend?! Nuk kemi për t’ju besuar kurrë.”

قَالُوا أَجِئْتَنَا لِنَلْفِتَنَّا عَمَّا وَجَدْنَا عَلَيْهِ

أَبَاءَنَا وَتَكُونَ لَكُمُ الْكِبْرِيَاءُ فِي الْأَرْضِ

وَمَا نَحْنُ لَكُمْ بِمُؤْمِنِينَ ﴿٧٩﴾

80. Dhe Faraoni tha: “Më sillni çdo magjistar mjeshtër.”

وَقَالَ فِرْعَوْنُ اسْتُونِي بِكُلِّ سِحْرِ عَلِيمٍ ﴿٨٠﴾

81. Kur erdhën magjistarët, u tha Musai: “Hidhni atë që keni për të hedhur.”

فَلَمَّا جَاءَ السَّحَرَةُ قَالَ لَهُمُ مُوسَىٰ ائْتُوا

مَا أَنْتُمْ مُّلتَمُونَ ﴿٨١﴾

82. E kur ata e hodhën, Musai tha: “Kjo që keni sjellë është vetëm magji; sigurisht, Allahu do ta zhbëjë atë. Sigurisht, Allahu nuk e mirëson punën e çrregulluesve.

فَلَمَّا اتَّقُوا قَالَ مُوسَىٰ مَا جِئْتُمْ بِهِ

السِّحْرُ إِنَّ اللَّهَ سَيَبْطِلُهُ إِنَّ اللَّهَ

لَا يُصْلِحُ عَمَلَ الْمُفْسِدِينَ ﴿٨٢﴾

83. Allahu e vërteton të vërtetën me fjalët e Tij, sado që ta urrejnë fajtorët.”<sup>17</sup>

وَيُحِقُّ اللَّهُ الْحَقَّ بِكَلِمَاتِهِ وَلَوْ كَرِهَ

الْمُجْرِمُونَ ﴿٨٣﴾

17. Një kauzë e drejtë nuk ka nevojë për mjetet e padrejta për përhapjen e saj. “Qëllimi justifikon mjetet” nuk ka qenë kurrë thënia e Profetëve të Zotit dhe e ndjekësve të tyre të vërtetë. E vërteta përhapet dhe triumfon përmes forcës së saj të natyrshme dhe jo përmes gënjeshtërisë. Koncepti i *tekijes*, pra, të gënjeshtërisë për rrethana të caktuara, nuk gjen asnjë bazë në Islam. Lexoni edhe 2:43; 41:43; 4:136.

84. Kështu, pak veta nga populli i tij e besuan Musain, pavarësisht nga frika se Faraoni dhe prijësit e tyre do t'i trazonin. Sigurisht, Faraoni ishte tiran në tokë dhe ai ishte shkelës.

فَمَا آمَنَ لِمُوسَىٰ إِلَّا ذُرِّيَّةٌ مِّنْ قَوْمِهِ عَلَىٰ خَوْفٍ مِّنْ فِرْعَوْنَ وَمَلَئِهِمْ أَن يَفْتِنَهُمْ ۗ وَإِنَّ فِرْعَوْنَ لَعَالٍ فِي الْأَرْضِ وَإِنَّهُ لَمِنَ الْمُسْرِفِينَ ﴿٨٤﴾

85. Dhe Musai tha: “O populli im! Nëse keni besuar në Allah, tek Ai mbështetuni, po qe se jeni nënshtruar (me të vërtetë).”

وَقَالَ مُوسَىٰ يُقَوْمُ إِن كُنتُمْ آمَنْتُمْ بِاللَّهِ فَعَلَيْهِ تَوَكَّلُوا إِن كُنتُمْ مُسْلِمِينَ ﴿٨٥﴾

86. Ata thanë: “Tek Allahu u mbështetëm. O Zoti ynë! Mos na bëj sprovë për popullin mizor,

فَقَالُوا عَلَى اللَّهِ تَوَكَّلْنَا ۗ رَبَّنَا لَا تَجْعَلْنَا فِتْنَةً لِّلْقَوْمِ الظَّالِمِينَ ﴿٨٦﴾

87. dhe me mëshirën Tënde na shpëto nga populli mohues!”

وَحِجَابًا بِرَحْمَتِكَ مِّنَ الْقَوْمِ الْكَافِرِينَ ﴿٨٧﴾

88. I shpallëm Musait dhe vëllait të tij: Përgatitni shtëpi për popullin tuaj në Egjipt, dhe shtëpitë tuaja ndërtojini përballë njëra-tjetrës, falni namazin dhe (ti, o Profet,) jepu lajmin e mirë besimtarëve.<sup>18</sup>

وَأَوْحَيْنَا إِلَىٰ مُوسَىٰ وَأَخِيهِ أَن تَبَوَّأْ لِقَوْمِكُمَا بِمِصْرَ بِيوتًا وَأَجْعَلُوا بِيوتَكُمْ قِبْلَةً وَأَقِيمُوا الصَّلَاةَ ۗ وَبَشِّرِ الْمُؤْمِنِينَ ﴿٨٨﴾

89. Dhe Musai tha: “O Zoti ynë! Ti i ke dhënë Faraonit dhe parisë së tij luks dhe pasuri të jetës së kësaj bote. O Zoti ynë! Mos vallë me qëllim që ata t'i devijojnë (të tjerët) nga rruga Jote?! O Zoti ynë! Shkatërrojua pasuritë dhe shtrëngojuua zemrat, sepse ata nuk do të besojnë derisa të shohin ndëshkimin e dhimbshëm.”

وَقَالَ مُوسَىٰ رَبَّنَا إِنَّكَ آتَيْتَ فِرْعَوْنَ وَمَلَئَهُ زِينَةً وَأَمْوَالًا فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا ۗ رَبَّنَا لِيُضِلُّوْا عَنْ سَبِيلِكَ ۗ رَبَّنَا اطْمِسْ عَلَىٰ أَمْوَالِهِمْ وَاشْدُدْ عَلَىٰ قُلُوبِهِمْ فَلَا يُؤْمِنُوا حَتَّىٰ يَرُوا الْعَذَابَ الْأَلِيمَ ﴿٨٩﴾

18. Një përkthim tjetër i kësaj pjese mund të jetë edhe ky: shtëpitë tuaja bëjini në drejtim të *kibles*. Sidoqoftë, qëllimi i udhëzimit Hyjnor duket se ishte që bijtë e Izraelit të jetonin afër njëri-tjetrit, në mënyrë që të ndihmonin njëri-tjetrin për çdo problem të tyre shoqëror.

90. Ai tha: Jua pranova lutjen ju të dyve, andaj, jini të qëndrueshëm dhe kurrsesi mos ndiqni rrugën e atyre që nuk dinë.

قَالَ قَدْ أُجِيبَت دَعْوَتُكُمَا فَاسْتَقِيمَا  
وَلَا تَتَّبِعِنَّ سَبِيلَ الَّذِينَ لَا يَعْلَمُونَ ﴿١٠﴾

91. Dhe Ne i kaluam bijtë e Izraelit matanë detit, atëherë Faraoni dhe ushtria e tij i ndoqën të rebeluar e të armiqësuar; kur ata i zuri fundosja; ai tha: “Besova se nuk ka të adhurueshëm tjetër përveç Atij që besuan bijtë e Izraelit dhe (edhe) unë bëhem ndër të nënshtruarit”.<sup>19</sup>

وَجَوَزْنَا بِبَنِي إِسْرَائِيلَ الْبَحْرَ فَأَتَبَعَهُمْ  
فِرْعَوْنُ وَجُوْدُهُ بَغِيًّا وَعَدْوًا حَتَّى إِذَا  
أَدْرَكَهُ الْعَرْقُ قَالَ أَمَنْتُ أَنَّهُ لَا إِلَهَ  
إِلَّا الَّذِي آمَنْتُ بِهِ بَنُو إِسْرَائِيلَ وَأَنَا مِنَ  
الْمُسْلِمِينَ ﴿١١﴾

92. Tani?! Por ti ke refuzuar deri më parë dhe ishe ndër çrregulluesit!

أَلَنْ وَقَدْ عَصَيْتَ قَبْلَ وَكُنْتَ مِنَ  
الْمُفْسِدِينَ ﴿١٢﴾

93. Andaj, sot ty ta shpëtojmë trupin, që të mbetesh shenjë për ata që vijnë pas teje. Në të vërtetë, shumica e njerëzve janë tërësisht të pavëmendshëm ndaj shenjave Tona.<sup>20</sup>

فَأَلْيَوْمَ نُنَجِّيكَ بِبَدَنِكَ لِتَكُونَ لِمَنْ  
حَلَفَكَ آيَةً ۗ وَإِنَّ كَثِيرًا مِنَ النَّاسِ عَنْ  
حُجَّتِ ابْنِنَا الْغَفْلُونَ ﴿١٣﴾

94. Ne u dhamë bijve të Izraelit vendbanim dinjitoz dhe u dhamë ushqime të pastra. Dhe ata nuk ranë

وَلَقَدْ بَوَّأْنَا بَنِي إِسْرَائِيلَ مَبَوَّأَ صَدَقِ  
وَرَزَقْنَاهُمْ مِنَ الظَّيْبِ ۚ فَمَا اخْتَلَفُوا حَتَّى

19. Ai që ka druajtje ndaj Zotit në kohë paqeje, shpëton në kohën e frikës. Kurse ai që i druhet Zotit në kohë frike, druajtja e tij është e padobishme. Në një situatë të tillë, edhe njeriu më i pafë si Faraoni i frikësohet Zotit. Çfarë fitoi Faraoni, përveç asaj që Zoti i tha – Unë do të të shpëtoj ty trupin, por jo jetën! Fjalët e Faraonit shprehin poshtërimin e thellë ku ai kishte përfunduar. Është interesante që Faraoni e adhuronte vetëm jetën e tij fizike, për atë iu lut Zotit kur gjendej mes vobullës së ndëshkimit, dhe Zoti bëri që pikërisht trupi i tij t'i bëhej shkaku i poshtërimit.

20. Edhe ky ajet tregon se Kuranin e Shenjtë e ka zbritur Zoti, Njohësi i së padukshmes, sepse deri në kohën e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, bota nuk kishte asnjë njohuri rreth kufomës së Faraonit. Vetëm në kohët tona u zbulua kufoma e Faraonit që ka jetuar gjatë kohës së Hazret Musait<sup>as</sup>. Kjo kufomë tregon se Faraonin e nxorën të gjallë nga fundosja për të jetuar vetëm në shtat si invalid rreth gjashtëdhjetë vite të tjera. Kështu, ai pati jetë rreth 90 vjet (Ian Wilson, “Exodus Enigma”).

në kundërshti derisa u erdhi dija. Sigurisht, Zoti yt do të vendosë mes tyre Ditën e Kiametit për atë që ata kundërshtonin.

95. Kështu që, nëse ke mëdyshje për atë që Ne të zbritëm ty, pyeti ata që lexojnë Librin (e shpallur) para teje. Sigurisht, ty të erdhi e vërteta nga Zoti yt, ndaj kurrsesi mos u bëj ndër dyshuesit.<sup>21</sup>

96. Dhe kurrsesi mos u bëj nga ata që i quajtën gënjeshtër shenjat e Allahut, sepse do të bëhesh ndër të humburit.

97. Sigurisht, ata për të cilët u vërtetua fjala e Zotit tënd, nuk do të besojnë,

98. edhe sikur t'u vijë çdo shenjë, gjersa ta shohin ndëshkimin e dhimbshëm.

99. Përveç popullit të Junusit, përse nuk u bë ndonjë vendbanim që të besonte (në atë mënyrë) që besimi i tij t'i bënte dobi?! Kur ata besuan, Ne ua larguam ndëshkimin poshtërues në këtë botë dhe për një kohë të caktuar, u siguruam mjetet e jetesës.<sup>22</sup>

جَاءَهُمُ الْعِلْمُ ۗ إِنَّ رَبَّكَ يَقْضِي بَيْنَهُمْ  
يَوْمَ الْقِيَامَةِ فِيمَا كَانُوا فِيهِ يَخْتَلِفُونَ ﴿٩٥﴾

فَإِنْ كُنْتُمْ فِي شَكٍّ مِّمَّا أَنْزَلْنَا إِلَيْكَ فَسْئَلِ  
الَّذِينَ يَقْرَأُونَ الْكِتَابَ مِنْ قَبْلِكَ ۗ لَقَدْ  
جَاءَكَ الْحَقُّ مِنْ رَبِّكَ ۗ فَلَا تَكُونَنَّ مِنَ  
الْمُتَرَدِّينَ ﴿٩٦﴾

وَلَا تَكُونَنَّ مِنَ الَّذِينَ كَذَّبُوا بِآيَاتِ اللَّهِ  
فَتَكُونُونَ مِنَ الْخَسِرِينَ ﴿٩٧﴾

إِنَّ الَّذِينَ حَقَّتْ عَلَيْهِمْ كَلِمَتُ رَبِّكَ  
لَا يُؤْمِنُونَ ﴿٩٨﴾

وَلَوْ جَاءَتْهُمْ كُلُّ آيَةٍ حَتَّى يَرَوْا الْعَذَابَ  
الْأَلِيمَ ﴿٩٩﴾

فَلَوْ لَا كَانَتْ قَرْيَةٌ أَمَنَتْ فَفَعَلَهَا إِيْمَانَهَا  
إِلَّا قَوْمَ يُونُسَ ۗ لَمَّا آمَنُوا كَشَفْنَا عَنْهُمْ  
عَذَابَ الْخُرِّي فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَمَتَّعْنَاهُمْ  
إِلَىٰ حِينٍ ﴿١٠٠﴾

21. Ajeti i drejtohet jo vetëm Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, por çdo lexuesi të Kuranit. Dikush mund të argumentojë se fjalët “atë që Ne të zbritëm ty” i drejtohet Profetit, por në disa ajete të Kuranit, përmendet që Kurani u zbrit për të gjithë (2:137; 21:11). Edhe ajeti tjetër e mbështet këtë pikëpamje, sepse vetë sipas Kuranit, Profeti i Shenjtë<sup>savs</sup> kurrsesi nuk mund të ishte prej atyre “që i quajtën gënjeshtër shenjat e Allahut”.

22. Kjo sure e tërë u quajt Junus, ku vjen edhe ky ajet, i cili përmban dëshmi të fuqishme të mëshirës së Zotit. Zoti u ka dhënë liri njerëzve në daç besojnë, në daç mohojnë, por këto fjalë patetike rrezatojnë dëshirë të fortë të Tij që bota të ndjekë udhëzimin Hyjnor për dobinë e

100. Dhe po të donte Zoti yt, do të besonin që të gjithë ata që banojnë në tokë. Ti, a do t'i imponosh vallë njerëzit, derisa të bëhen besimtarë?!<sup>23</sup>

101. Asnjë shpirt nuk mund të besojë, përveçse me lejen e Allahut. Mbi (fytyrat e tyre) ata që nuk mendojnë, Ai u vë ndyrësinë (e zemrës së tyre).

102. Thuaj: Vështroni atë që gjendet nëpër qiej dhe tokë. Nuk vlejné shenjat dhe alarmimet për njerëzit që nuk besojné.

103. Atëherë, çfarë presin ata përveç ditëve të atyre që ishin para tyre?! Thuaj: Prisni, edhe unë bashkë me ju pres.

104. Më pas, Ne kështu i shpëtojmë të Dërguarit Tanë dhe ata që besuan. Ne e kemi marrë përsipër të shpëtojmë besimtarët.

105. Thuaj: “O njerëz! Nëse keni dyshim për fenë time, unë nuk i adhuroj ata që ju i adhuroni në vend të Allahut, por adhuroj Allahun që ju jep vdekje, dhe jam urdhëruar të bëhem ndër besimtarët.”

وَلَوْ شَاءَ رَبُّكَ لَأَمَنَّ مِنَ فِي الْأَرْضِ كُلَّهُمْ جَمِيعًا أَفَأَنْتَ تُكْرِهُ النَّاسَ حَتَّى يَكُونُوا مُؤْمِنِينَ ﴿١٠٠﴾

وَمَا كَانَ لِنَفْسٍ أَنْ تُوْمِنَ إِلَّا بِإِذْنِ اللَّهِ ۗ وَيَجْعَلُ الرُّجْسَ عَلَى الَّذِينَ لَا يَعْقِلُونَ ﴿١٠١﴾

قُلْ انظُرُوا مَاذَا فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ۗ وَمَا تُعْجِبُ الْآيَاتِ وَالتُّدْرُ عَنْ قُوهِ ۗ لَّا يُؤْمِنُونَ ﴿١٠٢﴾

فَهَلْ يَنْتَظِرُونَ إِلَّا مِثْلَ أَيَّامِ الَّذِينَ خَلَوْا مِنْ قَبْلِهِمْ ۗ قُلْ فَانظُرُوا إِلَىٰ مَعَكُمْ مِنَ الْمُنْتَظِرِينَ ﴿١٠٣﴾

ثُمَّ نُنَجِّي رُسُلَنَا وَالَّذِينَ آمَنُوا كَذَلِكَ ۗ حَقًّا عَلَيْنَا نُنَجِّي الْمُؤْمِنِينَ ﴿١٠٤﴾

قُلْ يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِن كُنْتُمْ فِي شَكٍّ مِنْ دِينِي فَلَا أَعْبُدُ الَّذِينَ تَعْبُدُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ وَلَكِنْ أَعْبُدُ اللَّهَ الَّذِي يَتَوَفَّكُم ۗ وَأُمِرْتُ أَنْ أَكُونَ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ ﴿١٠٥﴾

vet. Junusi<sup>23</sup> është përmendur në gjashtë vende të ndryshme në Kuran (4:164; 6:87; 10:99; 21:88; 37:140 dhe 68:49). Në Bibël për të flitet si një Profet izraelit (2 Mbretërve 14:25) të cilit iu kërkua të shkonte në Ninive dhe të predikonte (Jona 1:2). Megjithatë, sipas Kuranit, ai u dërgua te populli i tij, siç pohohet edhe në këtë ajet. Andaj, mundet që ai të mos ketë qenë nga bijtë e Izraelit.

23. Edhe ky ajet është i qartë si drita e diellit se Islami nuk e lejon përdorimin e forcës për përhapjen e fesë.



106. Dhe si i nënshtruar (ndaj Allahut) përqendro vëmendjen tënde drejt fesë dhe kursesi mos u bëj ndër idhujtarët.

107. Dhe përveç Allahut, mos iu lut askujt, që nuk të bën dot as dobi e as dëm, sepse po e bëre, do të bëhesh ndër të padrejtët.

108. Nëse Allahu të prek me ndonjë vështirësi, s'ka kush që mund ta largojë atë, përveç Atij. Dhe nëse Ai do ndonjë të mirë për ty, nuk ka largues të bekimit të Tij. Ai ia jep kujt të dojë prej robërve të Tij dhe Ai është Falësi, Mëshirëbërësi.

109. Thuaj: "O njerëz! Juve ju ka ardhur e vërteta prej Zotit tuaj. Andaj, ai që udhëzohet, udhëzohet për veten e vet dhe ai që devijon, devijon kundër vetes së vet dhe unë nuk jam mbikëqyrës ndaj jush."

110. Ndiq atë që të shpallet ty dhe duro derisa të vendosë Allahu. Ai është më i miri për të vendosur.

وَأَنْ أَقِمَّ وَجْهَكَ لِلدِّينِ حَنِيفًا ۖ وَلَا تَكُونَنَّ مِنَ الْمُشْرِكِينَ ﴿١٠٦﴾

وَلَا تَدْعُ مِنْ دُونِ اللَّهِ مَا لَا يَنْفَعُكَ وَلَا يَضُرُّكَ ۚ فَإِنْ فَعَلْتَ فَإِنَّكَ إِذَا مِنَ الظَّالِمِينَ ﴿١٠٧﴾

وَإِنْ يَمْسَسْكَ اللَّهُ بِضُرٍّ فَلَا كَاشِفَ لَهُ إِلَّا هُوَ ۚ وَإِنْ يُرِدْكَ بِخَيْرٍ فَلَا رَادَّ لِفَضْلِهِ ۗ يُصِيبُ بِهِ مَنْ يَشَاءُ مِنْ عِبَادِهِ ۗ وَهُوَ الْغَفُورُ الرَّحِيمُ ﴿١٠٨﴾

قُلْ يَا أَيُّهَا النَّاسُ قَدْ جَاءَكُمْ الْحَقُّ مِنْ رَبِّكُمْ ۚ فَمَنِ اهْتَدَىٰ فَإِنَّمَا يَهْتَدِي لِنَفْسِهِ ۚ وَمَنْ ضَلَّٰ فَإِنَّمَا يَضِلُّ عَلَيْهَا ۚ وَمَا أَنَا عَلَيْكُمْ بِوَكِيلٍ ﴿١٠٩﴾

وَاتَّبِعْ مَا يُوحَىٰ إِلَيْكَ ۖ وَاصْبِرْ حَتَّىٰ يَحْكُمَ ۗ بِحُكْمِ اللَّهِ ۗ وَهُوَ خَيْرُ الْحَاكِمِينَ ﴿١١٠﴾

## Surja 11 – Hud

Surja Hud është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka njëqind e njëzet e katër ajete.

Për lidhjen e kësaj sureje me suren paraardhëse kemi thënë në parathënien e sures së mëparshme. Njëra ndër pikat e spikatura të kësaj sureje është ajo që përmendet në ajetin 113, ku thuhet: “Andaj, ngrihu siç je i urdhëruar ti dhe ai që u pendua bashkë me ty”. Kjo sure ngarkoi Profetin Muhammed<sup>savs</sup> me përgjegjësi kaq të madhe, saqë raportohet që ai u shpreh:

*“Surja Hud më ka plakur”*. (Tirmidhi, “Sunen”, kitab: “Tefsirul-Kuran ‘an Resulull-llahi<sup>savs</sup>”, hadithi nr. 3297)

Në suren Hud flitet për popujt që janë shkatërruar për shkak të mohimit. Edhe kjo e bregosi shumë Profetin Muhammed<sup>savs</sup>.

Ajeti nr. 18 i kësaj sureje sjell një dëshmi të mëparshme për vërtetësinë e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, pra, dëshminë e *Hazret Musait<sup>as</sup>* dhe, gjithashtu, flet edhe për një dëshmi të dytë, e cila do të lindte pas Profetit Muhammed<sup>savs</sup>. Kjo dëshmi përmendet edhe në suren El-Buruxh, në fjalët:

*“Betohem për dëshmitarin dhe për të dëshmuarin!”* (85:4)

Pra, do të vinte një kohë kur një dëshmitar i madh do të dëshmonte për vërtetësinë e një të dëshmuari të madh, domethënë për Profetin Muhammed<sup>savs</sup>.

Pas sures Hud vjen surja Jusuf, e cila fillon me rrëfimin e më të bukurës së historive, andaj surja Hud përfundon me porosinë se historitë e Profetëve që i shpallen Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, që të gjitha janë për t’ia forcuar zemrën Profetit<sup>savs</sup>. Kjo ka edhe një shenjë tjetër që me përmendjen e popujve në suren Hud, qëllimi nuk ishte që të lëndohej Profeti Muhammed<sup>savs</sup>.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. *Elif.Lam.Ra.* (Unë jam Allahu që shoh.)<sup>1</sup> Një Libër, ajetet e të cilit janë të vendosura, mandej të shpjeguara nga një (Zot) i Urtë, i Gjithinformuar,

الرَّحْمٰنِ كِتٰبٍ اٰحْكَمٰتٍ اٰیٰتُهُ ثُمَّ فُصِّلَتْ  
 مِنْ لَدُنِّ حَكِيْمٍ حٰیْرِ ①

3. që të mos adhuron dikë tjetër pos Allahut. Sigurisht, unë prej Tij jam për ju alarmues dhe sihariqdhënës.

اَلَّا تَعْبُدُوْا اِلَّا اللّٰهَ اِنِّیْ لَكُمْ مِّنْهُ نَذِيْرٌ  
 وَبَشِيْرٌ ②

4. Dhe që ju t'i kërkoni falje Zotit tuaj dhe të përuleni me pendesë pranë Tij, Ai do t'ju furnizojë me mjete të mira deri në një afat të caktuar dhe do t'i japë çdo të lartësuar lartësinë e tij. Nëse do ta ktheni shpinën, njëmend frikësohem nga ndëshkimi i një dite të madhe mbi ju.

وَ اِنْ اَسْتَغْفِرُوْا رَبَّكُمْ ثُمَّ تُوبُوْا اِلَيْهِ  
 يُمَتِّعْكُمْ مَّتَاعًا حَسَنًا اِلٰی اَجَلٍ مُّسَمًّى  
 وَ یُؤْتِ كُلَّ ذِي فَضْلٍ فَضْلَهُ ۗ وَاِنْ تَوَلَّوْا  
 فَاِنَّیْ اَخَافُ عَلَیْكُمْ عَذَابَ یَوْمٍ كَبِيْرٍ ③

5. Tek Allahu është kthimi juaj dhe Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë.

اِلٰی اللّٰهِ مَرْجِعُكُمْ ۚ وَهُوَ عَلٰی كُلِّ شَیْءٍ  
 قَدِيْرٌ ④

6. Dijeni! Ata dredhojnë kraharorët e tyre, që të fshihen nga Ai. Dijeni! (Edhe) kur i ndërrojnë rrobat e tyre, Ai e di atë që ata e fshehin dhe atë që e shfaqin. Sigurisht, Ai është i Gjithëdijshëm për ato që mbajnë kraharorët.<sup>2</sup>

اَلَا اِنَّهُمْ یُنۡتَوْنُ صُدُوْرَهُمْ لَیَسْتَخْفُوْا مِنْهُ  
 اِلَّا حَیۡنَ یَسْتَغْشَوْنَ ثِیَابَهُمْ ۗ لَیَعْلَمَ مَا  
 یُسِرُّوْنَ وَمَا یُعْلِنُوْنَ ۗ اِنَّهٗ عَلِيْمٌ بِذٰتِ  
 الصُّدُوْرِ ⑤

1. Një kuptim tjetër i këtyre shkurtesave është që shkronja *elif* përfaqëson *Allahun*, shkronja *lam* *Xhibrailin*, kurse *ra* të *Dërguarit* (arab. *rusul*). Për më shumë rreth shkurtesave të Kuranit, lexoni 2:2 dhe 7:2.

2. Mohuesit i mbajnë të fshehura dyshimet në mendjet e tyre dhe nuk i zbulojnë ato dhe as nuk

7. Nuk ka ndonjë gjallesë në tokë, përveçse Allahu ka marrë përsipër ushqimin e saj dhe Ai ia di edhe qëndrimin e përkohshëm, edhe qëndrimin e përhershëm. Çdo gjë është në një Libër të hapur.

8. Është Ai që krijoi qiejt dhe tokën në gjashtë ditë. Arshi i Tij është mbi ujë, që t'ju sprovovë se cili prej jush ka veprën më të mirë.<sup>3</sup> E nëse u thua: “Ju me siguri do të ngriheni pas vdekjes”, ata që mohuan, patjetër do të thonë: “Kjo është një gënjeshtër e hapur!”

9. Nëse ua largojmë ndëshkimin për një kohë të caktuar, ata me siguri do të thonë: “Çfarë e ndaloi atë?” Dijeni! Ditën kur do t'u vijë ai, nuk do të ketë rrugëdalje për ta dhe do t'i rrethojë ai (paralajmërim), me të cilin ata talleshin.

10. Nëse e bëjmë njeriun të shijojë një mëshirë nga ana Jonë dhe më pas ia rrëmbejmë, ai patjetër bëhet shumë i dëshpëruar dhe mosmirënjohës.

11. Dhe nëse e bëjmë të shijojë begati pas një vështirësie që e ka prekur, ai patjetër thotë: “Mua më janë larguar të këqijat!” Njëmend, (për gjëra të vogla) ai është i kënaqur, mendjemadh.

وَمَا مِنْ دَابَّةٍ فِي الْأَرْضِ إِلَّا عَلَى اللَّهِ رِزْقُهَا وَيَعْلَمُ مُسْتَقَرَّهَا وَمُسْتَوْدَعَهَا كُلِّ فِي كِتَابٍ مُبِينٍ ﴿٧﴾

وَهُوَ الَّذِي خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ فِي سِتَّةِ أَيَّامٍ وَكَانَ عَرْشُهُ عَلَى الْمَاءِ لِيَبْلُوَكُمْ أَيُّكُمْ أَحْسَنُ عَمَلًا وَلَئِنْ قُلْتُمْ إِنَّكُمْ مَبْعُوثُونَ مِنْ بَعْدِ الْمَوْتِ لَيَقُولَنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا إِنْ هَذَا إِلَّا سِحْرٌ مُبِينٌ ﴿٨﴾

وَلَئِنْ أَخْرْنَا عَنْهُمُ الْعَذَابَ إِلَى أُمَّةٍ مَعْدُودَةٍ لَيَقُولَنَّ مَا يَجِبُهَا إِلَّا يَوْمَ يَأْتِيهِمْ لَيْسَ مَصْرُوفًا عَنْهُمْ وَحَاقَ بِهِمْ مَا كَانُوا بِهِ يَسْتَهْزِئُونَ ﴿٩﴾

وَلَئِنْ أَدْقْنَا الْإِنْسَانَ مِنَّا رَحْمَةً ثُمَّ نَزَعْنَاهُ مِنْهُ إِنَّهُ لَيُؤَسُّ كَفُورٌ ﴿١٠﴾

وَلَئِنْ أَدْقْنَاهُ نِعْمَاءَ بَعْدَ ضَرَاءٍ مَسَّتْهُ لَيَقُولَنَّ ذَهَبَ السَّيِّئَاتُ عَنِّي إِنَّهُ لَفَرِحٌ فَخُورٌ ﴿١١﴾

përpiqen t'i largojnë ato. Arsyeja pse ata privohen të pranojnë të vërtetën është refuzimi i tyre për ta hapur zemrën dhe për t'i larguar dyshimet që kanë.

3. “Arshi (Froni) i Tij ishte mbi ujë” nuk do të thotë se *ma'adhallah* Arshi i Zotit noton në ujë, por do të thotë se bazën e jetës Ai e bëri me ujë. Madje edhe baza e jetës shpirtërore është e lidhur me “ujin” që u zbret Profetëve prej “qiellit”. Më shumë për Arshin, lexoni te 7:55.

12. Por jo ata që duruan dhe bënë të mira. Pikërisht këta do të kenë falje dhe shpërblim të madh.

إِلَّا الَّذِينَ صَبَرُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ  
أُولَئِكَ لَهُمْ مَغْفِرَةٌ وَأَجْرٌ كَبِيرٌ ﴿١٧﴾

13. Atëherë, a mundet që ti të lësh diçka nga ajo që të është shpallur ty e të ngushtohet kraharori sepse thonë: “Përse nuk iu zbrit ndonjë thesar” ose “Përse nuk erdhi me të ndonjë engjell?” Sigurisht, ti je vetëm një alarmues dhe Allahu është Mbikëqyrës për çdo gjë.

فَلَعَلَّكَ تَارِكٌ بَعْضُ مَا يُوحَىٰ إِلَيْكَ  
وَصَاحِبٌ بِهٖ صَدْرُكَ ۗ أَمْ يَقُولُونَ لَوْلَا  
أُنزِلَ عَلَيْهِ كُتُبٌ أَوْ جَاءَ مَعَهُ مَلَكٌ  
إِنَّمَا أَنْتَ نَذِيرٌ ۗ وَاللَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ  
وَكَيْلٌ ﴿١٨﴾

14. A thonë se ai e ka trilluar këtë? Thuaj: Sillni atëherë si këto dhjetë sure të trilluara dhe (për këtë) thirrni kë të doni (për ndihmë) përveç Allahut, nëse thoni të vërtetën.

أَمْ يَقُولُونَ افْتَرَاهُ ۗ قُلْ فَأْتُوا بِعَشْرِ سُوْرٍ  
مِّثْلِهِ مُفْتَرِيَاتٍ ۚ وَادْعُوا مَنِ اسْتَضَعْتُمْ مِّنْ  
دُونِ اللَّهِ إِن كُنْتُمْ صَادِقِينَ ﴿١٩﴾

15. E nëse nuk ju përgjigjen, dijeni se kjo është zbritur vetëm me dijen e Allahut dhe se nuk ka të adhurueshëm tjetër përveç Atij. Andaj, a do të jeni të nënshtruar?!

فَأَلَمْ يَسْتَجِيبُوا لَكُمْ فَاعْلَمُوا أَنَّمَا أُنزِلَ  
بِعِلْمِ اللَّهِ وَأَنَّ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ ۚ فَهَلْ أُنْتُمْ  
مُسْلِمُونَ ﴿٢٠﴾

16. Kushdo që do jetën e kësaj bote dhe zbukurimin e saj, Ne në këtë (botë) ia shpërblejmë veprat dhe nuk do t’ia pakësojmë.

مَنْ كَانَ يُرِيدِ الْحَيٰوةَ الدُّنْيَا وَزِينَتَهَا  
نُوْفِ إِلَيْهِمْ أَعْمَالَهُمْ فِيهَا وَ هُمْ فِيهَا  
لَا يُبْحَسُونَ ﴿٢١﴾

17. Pikërisht këta nuk do të kenë në *ahiret* asgjë përveç zjarrit dhe gjithçka që ata ndërjuan në këtë (botë), do të bjerë, dhe gjithçka që ata kanë vepruar, do të zhvlerësohet.

أُولَئِكَ الَّذِينَ لَيْسَ لَهُمْ فِي الْآخِرَةِ  
إِلَّا النَّارُ ۗ وَحِطَّ مَا صَنَعُوا فِيهَا وَ بَاطِلٌ  
مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿٢٢﴾

18. A mund (të jetë gënjeshtar) ai që qëndron mbi një shenjë të qartë prej Zotit të tij dhe atë e ndjek një dëshmitar prej Tij (pra, prej Zotit)

أَفَمَنْ كَانَ عَلَىٰ بَيِّنَةٍ مِّن رَّبِّهِ وَيَتْلُوهُ  
شَاهِدٌ مِّنْهُ وَمِنْ قَبْلِهِ كَتَبَ مُوسَىٰ إِمَامًا

dhe përpara tij ishte edhe Libri i Musait si udhërrëfyes dhe mëshirë?! Këta e besojnë atë. Dhe ai që e mohon atë nga grupet, zjarri është vendi i tij. Andaj, mos ki dyshim në këtë (çështje). Sigurisht, kjo është e vërteta prej Zotit tënd, por shumica e njerëzve nuk besojnë.<sup>4</sup>

19. E kush mund të jetë më keqbërës se ai që trillon gënjeshtër mbi Allahun?! Pikërisht këta do të paraqiten para Zotit të tyre dhe dëshmitarët do të thonë: “Këta janë që gënjen mbi Zotin e tyre.” Dijeni! Mallkimi i Allahut është mbi keqbërësit;

20. ata të cilët pengojnë nga rruga e Allahut dhe duan shtrembësi në të dhe pikërisht këta janë mohues të *ahiretit*.

21. Këta nuk mund t'i mundin (njerëzit e Zotit) në tokë dhe ata nuk mund të gjejnë ndonjë mik tjetër, duke e lënë Allahun. Atyre do t'u shtohet ndëshkimi. Ata as nuk do të kenë mundësi të dëgjojnë e as nuk do të mund të shohin.

وَرَحْمَةً ۖ أُولَٰئِكَ يُؤْمِنُونَ بِهِ ۖ وَمَنْ يَكْفُرْ بِهِ  
مِنَ الْأَحْزَابِ فَأِنَّارٌ مَّوْعَدُهُ ۚ فَلَا تَكُ فِي  
مَرْيَةٍ مِّنْهُ ۗ إِنَّهُ الْحَقُّ مِنْ رَبِّكَ ۗ وَلَكِنَّ  
أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يُؤْمِنُونَ ﴿١٨﴾

وَمَنْ أَظْلَمُ مِمَّنِ افْتَرَىٰ عَلَى اللَّهِ كَذِبًا ۖ  
أُولَٰئِكَ يُعْرَضُونَ عَلَىٰ رَبِّهِمْ وَيَقُولُ  
الْأَشْهَادُ هَٰؤُلَاءِ الَّذِينَ كَذَبُوا عَلَىٰ رَبِّهِمْ ۚ  
أَلَا لَعْنَةُ اللَّهِ عَلَى الظَّالِمِينَ ﴿١٩﴾

الَّذِينَ يَصُدُّونَ عَنِ سَبِيلِ اللَّهِ وَيَبْغُونَهَا  
عُوجًا ۖ وَهُمْ بِالْآخِرَةِ هُمْ كَافِرُونَ ﴿٢٠﴾

أُولَٰئِكَ لَمْ يَكُونُوا مُعْجِزِينَ فِي الْأَرْضِ  
وَمَا كَانَ لَهُمْ مِّنْ دُونِ اللَّهِ مِنْ أَوْلِيَاءٍ ۗ  
يُضْعَفُ لَهُمُ الْعَذَابُ ۖ مَا كَانُوا يَسْتَطِيعُونَ  
السَّمْعَ وَمَا كَانُوا يُبْصِرُونَ ﴿٢١﴾

وقيل لهم

4. Tri argumente janë dhënë në këtë ajet në mbështetje të Profetit të Shenjtë<sup>savs</sup> (1) “... ai qëndron mbi një shenjë të qartë prej Zotit të tij” (2) “... atë e ndjek një dëshmitar prej Zotit”, dhe (3) “përpara tij ishte edhe Libri i Musait si udhërrëfyes”. “Shenjë e qartë prej Zotit të tij” ishte revolucioni i madh moral që Profeti<sup>savs</sup> kishte sjellë në jetën e ndjekësve të tij, të cilët deri më parë ishin në vdekje shpirtërore, por që u bënë shembuj të gjallë të vërtetësisë së tij. Dëshmitari që do të vinte në të ardhmen për vërtetësinë e tij është Mesihu i Premtuar, Imam Mehdiu, në kohën kur drita e tij do të zbehet, njësoj siç Isai<sup>as</sup> erdhi pas Musait<sup>as</sup> si dëshmitar për ta mbështetur vërtetësinë e tij dhe të Teuratit në kohën e rënies morale të hebrenjve. Kurse pjesa e tretë, pra, “përpara tij ishte edhe Libri i Musait si udhërrëfyes” nënkupton profeci që gjenden në Bibël për ardhjen e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>.

22. Pikërisht këta e çuan veten në humbje dhe iu zhduk gjithçka që trillonin.

أُولَئِكَ الَّذِينَ خَسِرُوا أَنفُسَهُمْ وَصَلَّ  
عَنَّهُمْ مَا كَانُوا يَفْتَرُونَ ﴿٢٢﴾

23. Pa dyshim, në *ahiret* ata do të jenë humbësit më të mëdhenj.

لَا جَرَمَ لَهُمْ فِي الْآخِرَةِ هُمْ  
الْأَخْسَرُونَ ﴿٢٣﴾

24. Sigurisht, ata që besuan, bënë të mira dhe u përkulën drejt Zotit të tyre, janë banorë të xhenetit. Ata në të do të jetojnë përherë.<sup>5</sup>

إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ وَأَخْبَتُوا  
إِلَىٰ رَبِّهِمْ أُولَئِكَ أَصْحَابُ الْجَنَّةِ هُمْ فِيهَا  
خَالِدُونَ ﴿٢٤﴾

25. Shembulli i (këtyre) dy grupeve është si i të verbrit dhe i të shurdhrit dhe i shikuesit dhe i dëgjesit. A mund të jenë të barabartë këta në shembull?! A nuk mendoheni?!

مَثَلُ الْفَرِيقَيْنِ كَالْأَعْمَىٰ وَالْأَصْمَىٰ  
وَالْبَصِيرِ وَالسَّمِيعِ ۗ هَلْ يَسْتَوِينَ مَثَلًا  
أَفَلَا تَذَكَّرُونَ ﴿٢٥﴾

26. Sigurisht, Ne dërguam Nuhun drejt popullit të tij (që tha:) “Unë për ju jam alarmues i qartë;

وَلَقَدْ أَرْسَلْنَا نُوحًا إِلَىٰ قَوْمِهِ ۖ إِنِّي لَكُمْ  
نَذِيرٌ مُّبِينٌ ﴿٢٦﴾

27. që të mos adhuroni askënd përveç Allahut; unë frikësohem nga ndëshkimi i një dite të dhimbshme mbi ju”.

أَنْ لَا تَعْبُدُوا إِلَّا اللَّهَ ۗ إِنِّي أَخَافُ عَلَيْكُمْ  
عَذَابَ يَوْمِ آلِيمٍ ﴿٢٧﴾

28. Prijësit që mohuan nga populli i tij, thanë: “Ty të shohim një njeri një-soj si ne dhe shohim që ata që të ndoqën ty, në mendimin e përgjithshëm, janë më të parëndësishmit mes nesh dhe nuk shohim tek ju asnjë epërsi mbi ne; madje mendojmë se jeni gënjeshtarë”.

فَقَالَ الْمَلَأُ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ قَوْمِهِ  
مَا تَرْبِكَ إِلَّا بَشْرًا مِثْلَنَا وَمَا تَرْبِكَ  
تَتَّبَعَكَ إِلَّا الَّذِينَ هُمْ أَرَادُوا بِآدِي  
الرَّأْيِ ۗ وَمَا نَرَىٰ لَكُمْ عَلَيْنَا مِنْ فَضْلِ  
بَلْ نَنظُرُكُمْ كَذِبِينَ ﴿٢٨﴾

5. Për të arritur në shkallët më të larta të zhvillimit shpirtëror, përveç besimit të saktë, janë të domosdoshme edhe veprat e mira, nënshtrimi, bindja dhe dashuria e plotë dhe e përsosur për Allahun.

29. Ai tha: “O populli im! Mendoni, nëse unë qëndroj mbi një shenjë të qartë prej Zotit tim dhe Ai më dha prej Vetes mëshirë, dhe ju të mos e keni parë këtë, a mund t’jua detyrojmë, kur ju e urreni këtë?!”

30. Dhe o populli im! Nuk ju kërkoj para për këtë. Shpërblimi im është vetëm mbi Allahun dhe unë nuk kam për t’i përzënë ata që besuan. Sigurisht, ata do ta takojnë Zotin e tyre por unë ju ju shoh një popull të paditur.

31. Dhe o populli im! Po i përzura ata, kush do të më shpëtojë nga Allahu?! A nuk mendoheni?!

32. Nuk ju them se kam thesaret e Allahut, as nuk di të padukshmen, as nuk ju them se jam engjëll dhe as nuk ju them se ata që sytë tuaj i shohin të ulët, Allahu nuk ka për t’u dhënë mirësi. Allahu e di më së miri atë që kanë në shpirtin e tyre. (E po të them edhe unë si ju), do të jem ndër të padrejtët.”

33. Ata thanë: “O Nuh! Je grindur me ne dhe je grindur shumë. Sillna atë nga e cila po na alarmon, nëse thua të vërtetën!”

34. Ai tha: “Allahu do t’jua sjellë atë, nëse dëshiron, kurse ju nuk mund të jeni mundës.

35. Edhe sikur dëshiroj t’ju këshilloj, këshilla ime nuk do t’ju bëjë dobi,

قَالَ يَقَوْمِ أَرَأَيْتُمْ إِنْ كُنْتُمْ عَلَىٰ بَيِّنَةٍ  
مِّن رَّبِّي وَأَنبِئِي رَحْمَةً مِّن عِنْدِهِ فَعَمِيتَ  
عَلَيْكُمْ ۖ أَنذَرْتُمُوهَا وَأنتُمْ لَهَا  
كِرْهُونَ ﴿٢٩﴾

وَيَقَوْمِ لَا أَسْأَلُكُمْ عَلَيْهِ مَالًا إِنْ أَجْرِيَ  
إِلَّا عَلَى اللَّهِ وَمَا أَنَا بِطَارِدِ الَّذِينَ آمَنُوا  
إِنَّهُمْ مَلْفُوقُوا رَبِّهِمْ وَلَكِنِّي أَرَأَيْتُمْ قَوْمًا  
تَجْهَلُونَ ﴿٣٠﴾

وَيَقَوْمِ مَن يَنْصُرُنِي مِنَ اللَّهِ إِنْ طَرَدْتُهُمْ  
أَفَلَا تَذَكَّرُونَ ﴿٣١﴾

وَلَا أَقُولُ لَكُمْ عِندِي خَزَائِنُ اللَّهِ وَلَا  
أَعْلَمُ الْغَيْبَ وَلَا أَقُولُ إِنِّي مَلَكٌ وَلَا  
أَقُولُ لِلَّذِينَ تَزْدِرِي أَعْيُنُكُمْ لَنْ يُؤْتِيَهُمُ  
اللَّهُ خَيْرًا ۗ اللَّهُ أَعْلَمُ بِمَا فِي أَنفُسِهِمْ ۗ إِنِّي  
إِذَا لَمِنَ الظَّالِمِينَ ﴿٣٢﴾

قَالُوا يٰنُوحُ قَدْ جَدَلْنَا فَاكْثَرْتَ جِدَالِنَا  
فَأْتِنَا بِمَا تَعِدُنَا إِنْ كُنْتَ مِنَ الصّٰدِقِينَ ﴿٣٣﴾

قَالَ إِنَّمَا يَأْتِيكُمْ بِهِ اللَّهُ إِنْ شَاءَ وَمَا أَنْتُمْ  
بِمُعْجِزِينَ ﴿٣٤﴾

وَلَا يَنْفَعُكُمْ نُصْحِي إِنْ أَرَدْتُ أَنْ أَنْصَحَ



nëse Allahu dëshiron t'ju devijojë. Ai është Zoti juaj dhe tek Ai do të ktheheni.”

36. A thonë se e ka trilluar?! Thuaj: “Nëse e kam trilluar, mua do të më bjerë mëkati im. Dhe unë nuk kam përgjegjësi për mëkatet që bëni.”

37. Nuhut iu shpall: “Përveç atij që besoi, kurrsesi nuk do të besojë njeri tjetër nga populli yt, andaj, mos u brengos për atë që ata bëjnë.”<sup>6</sup>

38. Ndërto arkën para syve Tanë e sipas shpalljes Sonë dhe mos fol me Mua për ata që bënë të këqija. Ata përnjëmend do të mbyten.”

39. Ai po ndërtonte arkën; dhe sa herë që kalonte pranë tij ndonjë nga prijësit e popullit të tij, tallej me të. Ai tha: “Nëse talleni me ne, edhe ne do të tallemi me ju, siç talleni ju.

40. Kështu që, së shpejti do të mësoni, kujt do t'i vijë një ndëshkim që do ta poshtërojë atë dhe atij do t'i bjerë një ndëshkim i vazhdueshëm.”

41. Kur erdhi vendimi Ynë, shpërthyen burimet; (i) thamë (Nuhut): “Ngarko në të nga një çift

لَكُمْ إِنْ كَانَ اللَّهُ يُرِيدُ أَنْ يُغْوِيَكُمْ ۖ هُوَ رَبُّكُمْ وَإِلَيْهِ تُرْجَعُونَ ﴿٣٦﴾

أَمْ يَقُولُونَ افْتَرَيْنَاهُ ۖ قُلْ إِنْ افْتَرَيْتُهُ فَعَلَيْ إِجْرَامِي وَأَنَا بَرِيءٌ مِمَّا تُجْرِمُونَ ﴿٣٧﴾

وَأَوْحَىٰ إِلَىٰ نُوحٍ أَنَّهُ لَنْ يُؤْمِنَ مِنْ قَوْمِكَ إِلَّا مَنْ قَدْ آمَنَ فَلَا تَبْتَئِسْ بِمَا كَانُوا يَفْعَلُونَ ﴿٣٨﴾

وَأَصْبَحَ الْفُلْكَ بِأَعْيُنِنَا ۖ وَوَحْيًا وَلَا تَخَاطَبُنِي فِي الَّذِينَ ظَلَمُوا ۗ إِنَّهُمْ مُّخْرَقُونَ ﴿٣٩﴾

وَيَصْنَعُ الْفُلْكَ ۖ وَكَلَّمَا مَرَّ عَلَيْهِ مَلَأَ مِنْ قَوْمِهِ سَخِرُوا مِنْهُ ۖ قَالَ إِنْ تَسْخَرُوا مِنَّا فَإِنَّا نَسْخَرُ مِنْكُمْ كَمَا تَسْخَرُونَ ﴿٤٠﴾

فَسَوْفَ تَعْلَمُونَ ۗ مَنْ يَأْتِيهِ عَذَابٌ يُخْزِيهِ وَيَحِلُّ عَلَيْهِ عَذَابٌ مُّقِيمٌ ﴿٤١﴾

حَتَّىٰ إِذَا جَاءَ أَمْرُنَا وَفَارَ التَّنُّورُ ۗ قُلْنَا احْمِلْ فِيهَا مِنْ كُلِّ زَوْجَيْنِ اثْنَيْنِ وَأَهْلَكَ

6. Lutjen që ka bërë Hazret Nuhu<sup>as</sup> kundër popullit të tij, dhe që përmendet në 71:27-28, duket se e ka bërë pas shpalljes që përmendet në këtë ajet. Pra, sipas këtij ajeti, Allahu e njoftoi Nuhun<sup>as</sup> për vendimin e Tij që më asnjë njeri tjetër nga populli i tij nuk do të përmirësohej dhe nuk do të bëhej besimtar. Kjo tregon se mallkimi i Nuhut i përmendur në suren 71, nuk ishte gjë tjetër, veçse një lutje që të bëhej ajo që donte Zoti.

nga secila (gjallesë e nevojshme),<sup>7</sup> familjen tënde, përveç atij kundër të cilit është dhënë fjala, si dhe atë që besoi.” Dhe shumë pak besuan me të.

42. Dhe tha: “Hipni në të! Me emrin e Allahut është lundrimi dhe ankorimi i saj; sigurisht, Zoti im është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.”

43. Ajo lundronte bashkë me ta nëpër dallgë si male. Nuhu e thirri të birin, kur ai gjendej i veçuar: “O biri im! Bëhu udhëtar me ne dhe mos u bëj me mohuesit.”

44. Ai tha: “Unë së shpejti do të strehohem në një mal, që do të më shpëtojë nga uji.” (Nuhu) tha: “Nuk ka shpëtimtar sot nga urdhri i Allahut, përveç atij që Ai e mëshiron.” Dhe dallga i ndau ata dhe ai u bë ndër të mbyturit.

45. U tha: Oj tokë, gëlltite ujin tënd dhe, o qiell, pusho. Uji u shter, u krye çështja dhe (anija) u ndal në (malin) Xhudij, dhe u tha: U shkatërroftë populli keqbërës!<sup>8</sup>

إِلَّا مَنْ سَبَقَ عَلَيْهِ الْقَوْلُ وَمَنْ آمَنَ<sup>ط</sup>  
وَمَا آمَنَ مَعَهُ إِلَّا قَلِيلٌ<sup>٥١</sup>

وَقَالَ ارْكَبُوا فِيهَا بِسْمِ اللَّهِ مَجْرِبَهَا<sup>٥٢</sup>  
وَمُرْسَهَا<sup>٥٣</sup> إِنَّ رَبِّي لَغَفُورٌ رَحِيمٌ<sup>٥٤</sup>

وَهِيَ تَجْرِي بِهِمْ فِي مَوْجٍ كَالْجِبَالِ<sup>٥٥</sup>  
وَنَادَى نُوحٌ ابْنَهُ وَكَانَ فِي مَعْزِلٍ لِيُتَى<sup>٥٦</sup>  
ارْكَبْ مَعَنَا وَلَا تَكُنْ مَعَ الْكَافِرِينَ<sup>٥٧</sup>

قَالَ سَاوِيَ إِلَىٰ جِبَلٍ يَّعِصْمُنِي مِنَ الْمَاءِ<sup>٥٨</sup>  
قَالَ لَا عَاصِمَ الْيَوْمَ مِنْ أَمْرِ اللَّهِ إِلَّا<sup>٥٩</sup>  
مَنْ رَّحِمَهُ<sup>٦٠</sup> وَحَالَ بَيْنَهُمَا الْمَوْجُ فَكَانَ<sup>٦١</sup>  
مِنَ الْمُعْرِقِينَ<sup>٦٢</sup>

وَقِيلَ يَا أَرْضُ ابْلَعِي مَاءَكِ وَيَسَّاءِي أَقْلِعِي<sup>٦٣</sup>  
وَغِيضَ الْمَاءِ وَقُضِيَ الْأَمْرُ وَاسْتَوَتْ عَلَىٰ<sup>٦٤</sup>  
الْجُودِيِّ وَقِيلَ بُعْدًا لِلْقَوْمِ الظَّالِمِينَ<sup>٦٥</sup>

قرأ أحقص بفتح الحميم  
وإعماله الراء 12

7. Nuk bëhet fjalë për çiftin nga të gjitha gjallesat, se përndryshe anija veç për kafshët do të mbetej e vogël. Bëhet fjalë për kafshët që ata përdornin në jetën e përditshme.

8. Kurani i Shenjtë nuk përmend as përmasat e arkës së Nuhut<sup>as</sup>, dhe as idenë që përmytja e kohës së tij të ishte e përbotshme. Kurani përmend vetëm fjalën “toka” (arab. *el-erd*), që do të thotë vetëm toka ku Nuhu<sup>as</sup> jetoi e predikoi. Bibla përmend malin e Araratit si vendi ku arka e Nuhut ishte ankoruar (Zanafilla 8:4). Ararat mund të jetë fjalë arabe që zbërthehet si *arar-it*, d.m.th. “shoh majën e malit”. Kurse Kurani përmend *Xhudij* si ndalesë të arkës, dhe që në arabisht fjalë për fjalë do të thotë “*mirësia ime*”. Pra, me fjalë të tjera, Zoti thotë – Anija u ndal në mirësinë Time.

46. Dhe Nuhu thirri Zotin e tij dhe tha: “O Zoti im! Djali im është nga familja ime dhe sigurisht edhe premtimi Yt është i vërtetë, dhe Ti je më i drejti për të vendosur.”<sup>9</sup>

47. (Zoti) tha: “O Nuh! Ai nuk është nga familja jote. Ai ka vepër jo të pastër. Andaj, mos më kërko diçka që nuk ke dijeni për të. Të këshilloj që të mos bëhesh ndër të paditurit.”<sup>10</sup>

48. (Nuhu) tha. “O Zoti im! Ty të kërkoj mbrojtjen që të mos të pyes diçka për të cilën nuk kam dijeni. Dhe nëse nuk më fal dhe nuk më mëshiron, do të bëhem ndër të humburit.”

49. (Atëherë atij) iu tha: “O Nuh! Zbrit me paqe prej Nesh dhe me bekime mbi ty dhe mbi popuj që janë bashkë me ty!” Ka edhe popuj që do t’u japim mjetet (por) më pas do t’i prekë prej Nesh një ndëshkim i dhimbshëm.

50. Këto janë nga ato lajme të së padukshmes, që të shpallim ty. Ti vetë dhe as populli yt nuk mund

وَنَادَى نُوحٌ رَبَّهُ فَقَالَ رَبِّ إِنَّ ابْنِي مِنْ  
أَهْلِي وَإِنَّ وَعْدَكَ الْحَقُّ وَأَنْتَ أَحْكَمُ  
الْحَكَمِينَ ﴿٩﴾

قَالَ يُوحُ إِنَّهُ لَيْسَ مِنْ أَهْلِكَ  
إِنَّهُ عَمَلٌ غَيْرُ صَالِحٍ فَلَا تَسْأَلِنِ مَا لَيْسَ  
لَكَ بِهِ عِلْمٌ إِنِّي أَعِظُكَ أَنْ تَكُونَ  
مِنَ الْجَاهِلِينَ ﴿١٠﴾

قَالَ رَبِّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ أَنْ أَسْأَلَكَ مَا لَيْسَ  
لِي بِهِ عِلْمٌ وَإِلَّا تَغْفِرْ لِي وَتَرْحَمْنِي  
أَكُنَّ مِنَ الْخَسِرِينَ ﴿١١﴾

قِيلَ يُوحُ اهْبِطْ بِسَلَامٍ مِنَّا وَبَرَكَاتٍ عَلَيْكَ  
وَعَلَىٰ أُمَّةٍ مِّمَّنْ مَعَكَ وَأُمَّةٍ سَمَّيْتَهُمْ  
ثُمَّ يَمَسُّهُمْ مِنَّا عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿١٢﴾

تِلْكَ مِنْ أَنْبَاءِ الْغَيْبِ نُوحِيهَا إِلَيْكَ مَا  
كُنْتَ تَعْلَمُهَا أَنْتَ وَلَا قَوْمُكَ مِنْ قَبْلِ

9. Ky ajet ilustron bukur se sa shumë respekt kanë Profetët ndaj Zotit edhe në sprova tejet të vështira. Duke e keqkuptuar premtimin e Zotit, Hazret Nuhu<sup>as</sup> kishte menduar se Zoti do t’i shpëtonte nga përmbytja të gjithë anëtarët e familjes së tij, por pa që djali i tij do të mbytej. Vallë, a mund të jetë diçka tjetër më e rëndë për njeriun sesa të shikojë djalin e vet duke u mbytur?! Megjithatë, duke iu lutur Zotit, Hazret Nuhu<sup>as</sup> e thekson se premtimi i Zotit patjetër është i vërtetë dhe se gabimi mund të jetë vetëm në gjykimin e vetë Nuhut<sup>as</sup>.

10. Këto fjalë tregojnë qartë se fëmijët e vërtetë të Profetëve janë ata që i pranojnë. Kurani e thekson se besimtarët trashëgojnë bekimet e Profetëve të tyre për shkak të lidhjes shpirtërore me Profetët, e jo thjesht për shkak të lidhjeve të gjakut me ta.

t'i dinit deri më parë. Andaj, duro. Fundi është i atyre që kanë drojë (ndaj Allahut).

51. Dhe adëve u kemi dërguar Hudin, vëllain e tyre. Ai tha: “O populli im! Adhuroni Allahun. Nuk keni të adhureshëm tjetër përveç Atij. Ju vetëm trilloni.

52. O populli im! Nuk ju kërkoj shpërblim për këtë. Shpërblimi im është vetëm mbi Atë që më krijoi. A nuk mendoni?!

53. Dhe o populli im! Kërkojini falje Zotit tuaj, më pas përuluni me pendesë tek Ai. Ai do t'ju dërgojë re me shi të vazhdueshëm, dhe forcës suaj do t'ia shtojë forcën edhe më shumë dhe ju mos e ktheni shpinën si keqbërës.”

54. Ata thanë: “O Hud! Nuk na solle ndonjë shenjë të qartë, dhe vetëm për fjalën tënde nuk kemi për të braktisur zotat tanë dhe nuk kemi për të të besuar;

55. themi vetëm që ndonjë nga zotat tanë të la ty hije të keqe.” (Hudi) tha: “Unë e sjell Allahun si dëshmitar dhe jini (edhe) ju dëshmitarë që jam i distancuar nga ajo që adhuroni,

56. përveç Atij; andaj, ju të gjithë së bashku intrigoni kundër meje, pa më lënë kohë.

هَذَا قَاصِرٌ ۖ إِنَّ الْعَاقِبَةَ لِلْمُتَّقِينَ ﴿٥٠﴾

وَإِلَىٰ عَادٍ أَخَاهُمْ هُودًا ۖ قَالَ يَقَوْمِ اعْبُدُوا  
اللَّهَ مَا لَكُمْ مِّنَ اللَّهِ غَيْرُهُ ۖ إِنَّا أَنكُمُ إِلَّا  
مُفْتَرُونَ ﴿٥١﴾

يَقَوْمِ لَا أَسْأَلُكُمْ عَلَيْهِ أَجْرًا ۖ إِنَّا أَجْرِي  
إِلَّا عَلَىٰ الَّذِي فَطَرَنِي ۖ أَفَلَا تَعْقِلُونَ ﴿٥٢﴾

وَيَقَوْمِ اسْتَغْفِرُوا رَبَّكُمْ ثُمَّ تُوبُوا إِلَيْهِ  
يُرْسِلِ السَّمَاءَ عَلَيْكُمْ مِدْرَارًا وَيَزِدْكُمْ  
قُوَّةً إِلَىٰ قُوَّتِكُمْ وَلَا تَتَوَلَّوْا مُجْرِمِينَ ﴿٥٣﴾

قَالُوا يَهُودُ مَا جِئْتَنَا بِبَيِّنَةٍ ۖ وَمَا نَحْنُ  
بِتَارِكِي آلِهَتِنَا عَنْ قَوْلِكَ ۖ وَمَا نَحْنُ لَكَ  
بِمُؤْمِنِينَ ﴿٥٤﴾

إِن تَقُولُ إِلَّا اعْتَرَاكَ بَعْضُ آلِهَتِنَا  
بِسُوءٍ ۖ قَالَ إِنِّي أَسْهَدُ اللَّهَ ۖ وَاشْهَدُوا أَنِّي  
بِرَبِّي ۖ مِمَّا تَشْرِكُونَ ﴿٥٥﴾

مَنْ دُونِهِ فَكَيْدُونِي جَمِيعًا ۖ ثُمَّ  
لَا تُنظِرُونَ ﴿٥٦﴾

57. Unë u mbështeta tek Allahu, Zoti im dhe Zoti juaj. Nuk ka gjallesë që Ai nuk e ka në dorë ballin e saj. Sigurisht, Zoti im është në rrugë të drejtë.

58. Andaj, nëse e ktheni shpinën, unë tanimë jua kam dhënë atë me të cilën kam ardhur tek ju. Dhe Zoti im do të zgjedhë mëkëmbës popull tjetër përveç jush, kurse ju nuk mund ta dëmtoni Atë aspak. Sigurisht, Zoti im është Mbrojtës mbi çdo gjë.”

59. E kur erdhi vendimi Ynë, shpëtuam Hudin si dhe ata që besuan bashkë me të, përmes mëshirës prej Nesh dhe i shpëtuam nga një ndëshkim i rëndë.

60. E këta ishin adët. Mohuan shenjat e Zotit të tyre, refuzuan të Dërguarit e Tij dhe ndoqën vetëm urdhrat e çdo tirani, rebeli.

61. Ata i ndoqi një mallkim edhe në këtë botë, edhe në Ditën e Kiametit. Dijeni! Adët e mohuan Zotin e tyre. Dëgjoni! U shkatërrroshin adët, populli i Hudit!

62. (Ne u dërguam) themudëve vëllain e tyre, Salihun. Ai tha: “O populli im! Adhuroni Allahun. Nuk keni ndonjë të adhurueshëm tjetër përveç Atij. Ai ju bëri prej tokës, ju ngriti në të, ndaj, Atij i kërkoni falje, më pas përuluni me pendesë tek Ai. Sigurisht, Zoti im, është i Afërt, Pranues.”

إِنِّي تَوَكَّلْتُ عَلَى اللَّهِ رَبِّي وَرَبِّكُمْ ۗ مَا مِنْ دَابَّةٍ إِلَّا هُوَ آخِذٌ بِنَاصِيَتِهَا ۗ إِنَّ رَبِّي عَلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ ﴿٥٧﴾

فَإِنْ تَوَلَّوْا فَقَدْ أَبْلَغْتُكُمْ مَا أُرْسِلْتُ بِهِ إِلَيْكُمْ ۗ وَيَسْتَخْلِفُ رَبِّي قَوْمًا غَيْرَكُمْ ۚ وَلَا تَضُرُّوهُ شَيْئًا ۗ إِنَّ رَبِّي عَلَى كُلِّ شَيْءٍ حَفِيظٌ ﴿٥٨﴾

وَلَمَّا جَاءَ أَمْرُنَا نَجَّيْنَا هُودًا وَالَّذِينَ آمَنُوا مَعَهُ بِرَحْمَةٍ مِنَّا ۚ وَنَجَّيْنَاهُمْ مِّنْ عَذَابٍ غَلِيظٍ ﴿٥٩﴾

وَتِلْكَ عَادٌ ۗ جَحَدُوا بِآيَاتِ رَبِّهِمْ وَعَصَوْا رُسُلَهُ وَاتَّبَعُوا أَمْرَ كُلِّ جَبَّارٍ عَنِيدٍ ﴿٦٠﴾

وَأَتَّبَعُوا فِي هَذِهِ الدُّنْيَا لَعْنَةً ۗ وَيَوْمَ الْقِيَامَةِ ۗ أَلَا إِنَّ عَادًا كَفَرُوا رَبَّهُمْ ۗ أَلَا بُعْدًا لِّعَادٍ ۗ قَوْمِ هُودٍ ﴿٦١﴾

وَالِي تَمُودَ أَخَاهُمْ صَالِحًا ۗ قَالَ يَا قَوْمِ اعْبُدُوا اللَّهَ مَا لَكُمْ مِنْ إِلَهٍ غَيْرُهُ ۗ هُوَ أَنشَأَكُمْ مِنَ الْأَرْضِ وَاسْتَعْمَرَكُمْ فِيهَا فَاسْتَعِفَرُوهُ ۗ ثُمَّ تَوَبُّوا إِلَيْهِ ۗ إِنَّ رَبِّي قَرِيبٌ مُّجِيبٌ ﴿٦٢﴾

63. Ata thanë: “O Salih! Ti ishe shpresë mes nesh deri më parë. A na ndalon ta adhurojmë atë që kanë adhuruar baballarët tanë?! Për atë që na thërret ti, jemi në dyshim shqetësues.”

64. Ai tha: “O populli im! Më thoni nëse unë jam mbi një shenjë të qartë prej Zotit tim dhe Ai më dha mëshirë prej Vetes, atëherë kush do të më ndihmojë kundër Allahut, nëse nuk i bindem Atij?! Pra, ju më shkaktoni veç humbje.

65. Dhe o populli im! Kjo është deveja e Allahut, një shenjë për ju. Lëreni të kullotet në tokën e Allahut dhe mos i bëni keq, se përndryshe, do t’ju zërë një ndëshkim i afërt.”

66. Atëherë ata ia prenë këmbët (duke e therur) dhe ai u tha: “Përfitoni në shtëpitë tuaja edhe tri ditë! Ky është premtim i pakthyeshëm.”

67. E kur erdhi vendimi Ynë, shpëtuam Salihun si dhe ata që besuan bashkë me të, përmes mëshirës prej Nesh dhe (i shpëtuam) nga poshtërimi i asaj dite. Sigurisht, vetëm Zoti yt është i Forti, i Plotfuqishmi.

68. Kurse ata që bënë të këqija, i zuri krisma, aq saqë ata mbetën të gjunjëzuar në shtëpitë e tyre;

قَالُوا يٰصٰلِحُ قَدْ كُنْتَ فِىنَا مَرْجُوًّا قَبْلَ هٰذَا  
اَتَهٰنَا اَنْ نَّعْبُدَ مَا يَعْبُدُ اٰبَاؤُنَا وَاِنَّا لَفِى  
شَكٍّ مِّمَّا تَدْعُوْنَآ اِلَيْهِ مُرِيبٍ ﴿١٣﴾

قَالَ يٰقَوْمِ اَرَايْتُمْ اِنْ كُنْتُ عَلَىٰ بَيِّنَةٍ  
مِّنْ رَّبِّىْ وَاُنۢبِىٓ مِنْهُ رَحْمَةً فَمَنْ يُّنۢصِرُنِىْ  
مِنَ اللّٰهِ اِنْ عَصَيْتُهُۥ فَمَا تَزِيدُوْنِىْ  
غَيْرَ تَخۢسِيۢرٍ ﴿١٤﴾

وَيَقَوْمِ هٰذِهِ نَاقَةٌ اللّٰهُ لَكُمْ اٰيَةٌ فَذُرُوْهَا  
تَاْكُلْ فِىۡ اَرْضِ اللّٰهِ وَلَا تَمۡسُوْهَا بِسُوۡءٍ  
فَيَاۡحُذَّكُمْ عَذَابٌ قَرِيبٌ ﴿١٥﴾

فَعَقَرُوْهَا فَقَالَ تَمَّعُوْا فِىۡ دَارِكُمْ ثَلَاثَةَ  
اَيَّامٍ ۗ ذٰلِكَ وَعَدۡ غَيْرُ مَكۡذُوۡبٍ ﴿١٦﴾

فَلَمَّا جَاءَ اَمْرُنَا نَجَّيۡنَا صٰلِحًا وَّ الَّذِيۡنَ  
اٰمَنُوۡا مَعَهٗ بِرَحْمَتِىۡ مِنۡنَا وَاَمۡنَ خُرۡى يَوْمَئِذٍ  
اِنَّ رَبَّكَ هُوَ الْقَوِىُّ الْعَزِيۡزُ ﴿١٧﴾

وَآخَذَ الَّذِيۡنَ ظَلَمُوۡا الصَّيْحَةَ فَاصۡبَحُوۡا  
فِىۡ دِيَارِهِمۡ جَثِيۡمِيۡنَ ﴿١٨﴾

69. sikur nuk kishin ekzistuar në to. Dëgjoni! Themudët e mohuan Zotin e tyre! Dëgjoni! U shkatërrofshin themudët!

70. Sigurisht, edhe Ibrahimit i erdhën të dërguarit Tanë me lajmin e mirë; thanë: “Paqe!” Ai tha: “Paqe!” Dhe pa u vonuar, u sollli një vësh të pjekur.

71. E kur pa që duart e tyre nuk i afroreshin, i pandehu për të tjerë dhe ndjeu frikë prej tyre. Ata thanë: “Mos ki frikë, ne jemi dërguar te populli i Lutit.”

72. Dhe gruaja e tij (që aty) po qëndronte, buzëqeshi, atëherë Ne i dhamë lajmin e mirë të Is'hakut, e pas Is'hakut edhe të Jakubit.

73. Ajo tha: “Mjerë unë! Unë do të lind?! Por jam plakë dhe ky burri im është i moshuar! Kjo përnjëmend është një gjë e çuditshme!”

74. Ata thanë: “A çuditësh nga vendimi i Allahut?! Mëshira e Allahut dhe bekimet e Tij qofshin mbi ju o anëtarët e shtëpisë! Sigurisht, Ai është i Lavdëruar, i Madhëruar.”

75. Kur Ibrahimit iu largua frika dhe atij i erdhi lajmi i mirë, filloi të argumentonte me Ne për popullin e Lutit.

76. Pa dyshim, Ibrahimit ishte shumë i dhembshur, zemërbutë, i përlur.

كَانَ لَّمْ يُعْمَوُا فِيهَا إِلَّا إِنَّ تَمُودًا كَفَرُوا  
لَمْ رَبَّهُمْ إِلَّا بَعْدًا تَمُودًا ⑤

وَلَقَدْ جَاءَتْ رُسُلَنَا إِبْرَاهِيمَ بِالْبَشْرَى  
قَالُوا سَلَامًا قَالَ سَلَمًا فَمَا لِيثَ أَنْ جَاءَ  
بِعَجَلٍ حَيْنًا ⑥

فَلَمَّا رَأَى أَيْدِيَهُمْ لَا تَصِلُ إِلَيْهِ نَكِرَهُمْ  
وَأَوْجَسَ مِنْهُمْ خِيفَةً ⑦ قَالُوا لَا تَخَفْ إِنَّا  
أُرْسِلْنَا إِلَى قَوْمٍ لُوطٍ ⑧

وَأَمْرَاتُهُ قَابِلَةً فَصَحَّكَتَ فَبَشَّرْنَاهَا  
بِإِسْحَاقَ وَمِنْ وَرَاءِ إِسْحَاقَ يَعْقُوبَ ⑨

قَالَتْ يَوَيْلَىٰ ءِ أَلِدُ وَ أَنَا عَجُوزٌ وَ هَذَا  
بَعْلِي شَيْخًا إِنَّ هَذَا لَشَيْءٌ عَجِيبٌ ⑩

قَالُوا أَتَعْجَبِينَ مِنْ أَمْرِ اللَّهِ رَحِمَتُ اللَّهِ  
وَ بَرَكَتُهُ عَلَيْكُمْ أَهْلَ الْبَيْتِ إِنَّهُ حَمِيدٌ  
مُعْتَدٌ ⑪

فَلَمَّا ذَهَبَ عَنْ إِبْرَاهِيمَ الرَّوْعُ وَ جَاءَتْهُ  
الْبَشْرَى يُجَادِلُنَا فِي قَوْمِ لُوطٍ ⑫

إِنَّ إِبْرَاهِيمَ لَحَلِيمٌ أَوَّاهٌ مُنِيبٌ ⑬

77. “O Ibrahim! Shmangu nga kjo (kërkesë), vendimi i Zotit tënd pa dyshim ka ardhur dhe atyre përnjëmend do t’u vijë një ndëshkim i pashmangshëm.”

78. E kur të dërguarit Tanë i mbërritën Lutit, atij i erdhi keq prej tyre, iu shtrëngua zemra dhe tha: “Kjo është një ditë e rëndë!”

79. Populli i tij me vrap erdhi tek ai, dhe edhe më parë ata bënë të këqija. (Luti) tha: “O populli im! Këto janë bijat e mia, ato janë të pastra (edhe) tek ju. Andaj, kini druajtjen ndaj Allahut dhe mos më turpëroni mes miqve të mi! A nuk keni asnjë burrë të mençur?!”

80. (Duke dredhuar fjalën) ata thanë: “Ti e di mirë që nuk kemi asnjë të drejtë për bijat e tua dhe ti e di mirë edhe atë që ne kërkojmë.”<sup>11</sup>

81. Ai tha: “Sikur të kisha fuqi përballë jush ose t’i mbështetesa ndonjë shtyllë të fuqishme!”<sup>12</sup>

82. (Të dërguarit) thanë: “O Lut! Jemi të dërguarit e Zotit tënd. Këta kurrsesi nuk mund të të afrohen. Andaj, në një copë të natës, ti bashkë

يَا إِبْرَاهِيمُ أَعْرِضْ عَنْ هَذَا ۖ إِنَّهُ قَدْ جَاءَ  
أَمْرٌ رَبِّكَ ۖ وَاللَّهُمَّ اتِّبِعْ عَذَابَ غَيْرِ  
مَرْدُودٍ ﴿٧٧﴾

وَلَمَّا جَاءَتْ رُسُلُنَا لُوطًا سِئًا بِهِمْ وَ  
صَاقَ بِهِمْ ذُرْعًا ۖ وَقَالَ هَذَا يَوْمٌ  
عَصِيبٌ ﴿٧٨﴾

وَجَاءَهُ قَوْمُهُ يُهْرَعُونَ إِلَيْهِ ۖ وَمِنْ  
قَبْلُ كَانُوا يَعْمَلُونَ السَّيِّئَاتِ ۖ قَالَ يَاقَوْمِ  
هُؤُلَاءِ بَنَاتِي هُنَّ أَطْهَرُ لَكُمْ فَاتَّقُوا اللَّهَ  
وَلَا تُخْزَوْنَ فِي صَيْفِي ۖ آيِسَ مِنْكُمْ  
رَجُلٌ رَشِيدٌ ﴿٧٩﴾

قَالُوا لَقَدْ عَلِمْتَ مَا لَنَا فِي بَنَاتِكَ مِنْ حَقٍّ ۖ  
وَإِنَّكَ لَتَعْلَمُ مَا نُرِيدُ ﴿٨٠﴾

قَالَ لَوْ أَنَّ لِي بِكُمْ قُوَّةٌ أَوْ آوِيٌّ إِلَى  
رُكْنٍ شَدِيدٍ ﴿٨١﴾

قَالُوا يَلُوطُ إِنَّا رُسُلُ رَبِّكَ لَنْ يَصْلَوْا  
إِلَيْكَ فَأَسْرِ بِأَهْلِكَ بِقِطْعٍ مِّنَ اللَّيْلِ  
وَلَا يَلْتَفِتْ مِنْكُمْ أَحَدٌ إِلَّا أَمْرَاتَكَ ۖ

11. Për ajetet 78 – 80 disa komentues thonë se *Hazret Luti*<sup>as</sup>, popullit të tij ia “paraqiti” vajzat e veta, por kjo nuk është e saktë. E vërteta është që populli i Lutit pasi e mohoi atë, mendonte se ai po bënte kurth kundër tyre bashkë me disa njerëz të huaj që i kishte ftuar në shtëpi. *Hazret Luti*<sup>as</sup> iu përgjigj me një pyetje retorike duke thënë – Vajzat e mia janë të martuara në shtëpitë tuaja, andaj si mund të bëj kurth unë kundër jush?!

12. D.m.th. unë lus Zotin që të shpëtoj nga poshtërimi që ju po më bëni, duke këmbëngulur që t’i largoj mysafirët e mi të nderuar.



me anëtarët dil nga shtëpia dhe askush prej jush të mos e kthejë kokën mbrapa, (por në premtim) bën përjashtim gruaja jote, edhe atë do ta zërë ajo që ka për t'i zërë ata. Afati i tyre i premtuar është mëngjesi. A nuk është afër mëngjesi?!”

83. Kur erdhi vendimi Ynë, e rrokullisëm (vendin) dhe lëshuam breshëri gurësh, të përbërë prej balte të thatë,

84. të shënuar te Zoti yt. Kjo nuk ishte e largët prej keqbërësve.

85. Dhe medjenëve<sup>13</sup> u dërguam vëllain e tyre, Shuajbin. Ai tha: “O populli im! Adhuroni Allahun; nuk keni ndonjë të adhureshëm tjetër përveç Atij. Dhe mos pakësoni në matjen dhe peshoren. Sigurisht, unë ju shoh të pasur dhe frikësohem që t’ju zërë ndëshkimi i një dite që do t’ju rrethojë.

86. Dhe o populli im! Jepni të plota me drejtësi matjen dhe peshoren, mos ua pakësoni njerëzve gjërat e tyre dhe mos bëni trazira si ngatërrestarë në tokë.

87. Teprica (që vjen në tregti) prej Allahut është më e mirë për ju, në qoftë se jeni besimtarë. Unë nuk jam mbikëqyrës për ju.”

إِنَّهُ مُصِيبُهَا مَا أَصَابَهُمْ ۗ إِنَّ مَوْعِدَهُمُ  
الصُّبْحُ ۗ أَلَيْسَ الصُّبْحُ بِقَرِيبٍ ۝٨٦

فَلَمَّا جَاءَ أَمْرُنَا جَعَلْنَا عَلَيَّهَا سَافِلَهَا  
وَأَمْطَرْنَا عَلَيْهَا حِجَارَةً مِّن سِجِّيلٍ  
مَّنصُودٍ ۝٨٧

مُسَوَّمَةً عِنْدَ رَبِّكَ ۗ وَمَا هِيَ مِنَ الظَّالِمِينَ  
بَعِيدٍ ۝٨٨

وَالِى مَدِينِ أَخَاهُمْ شُعَيْبًا ۗ قَالَ  
يَقَوْمِ اعْبُدُوا اللَّهَ مَا لَكُم مِّنْ إِلَهٍ غَيْرُهُ ۗ  
وَلَا تَتَّقُوا الْمَكِّيَالَ وَالْمِيزَانَ  
إِنِّي أَرَاكُمْ بِخَيْرٍ وَإِنِّي أَخَافُ  
عَلَيْكُمْ عَذَابَ يَوْمٍ مُّحِيطٍ ۝٨٩

وَيَقَوْمِ أَوْفُوا الْمِكْيَالَ وَالْمِيزَانَ  
بِالْقِسْطِ ۗ وَلَا تَبْخَسُوا النَّاسَ أَشْيَاءَهُمْ  
وَلَا تَعْتُوا فِي الْأَرْضِ مُفْسِدِينَ ۝٩٠

بَقِيَّتُ اللَّهِ خَيْرٌ لَّكُمْ إِن كُنتُمْ مُؤْمِنِينَ ۗ  
وَمَا أَنَا عَلَيْكُمْ بِحَفِيظٍ ۝٩١

13. Lexoni 7:86.

88. Ata thanë: “O Shuajb! Namazi yt a të urdhëron që ne të braktisim ato që etërit tanë adhuronin ose të (mos) bëjmë si të duam me pasuritë tona?! Ti (hiqesh) shumë i dhembshur (dhe) i mençur!”

89. Ai tha: “O populli im! Më thoni nëse unë qëndroj mbi një shenjë të qartë prej Zotit tim dhe Ai më jep ushqim të pastër prej Vetes (a mund të veproj siç thoni ju?!). Nuk dua të bëj diçka që jua ndaloj juve. Dua vetëm përmirësimin sa të kem fuqi, dhe mundësia ime është vetëm prej Allahut. Atij i jam mbështetur dhe tek Ai anoj.

90. Dhe o populli im! Armiqësia me mua le të mos bëhet shkak që t’ju godasë e njëjta gjë që e goditi popullin e Nuhut, popullin e Hudit ose popullin e Salihut. Edhe populli i Lutit nuk është larg prej jush.

91. Kërkojini falje Zotit tuaj, pastaj përluni me pendesë tek Ai! Njëmend, Zoti im është shumë Mëshirëbërës, shumë i Dashur.”

92. Ata thanë: “O Shuajb! Nuk e kuptojmë shumicën e asaj që na thua dhe ty të shohim si të dobët mes nesh. Po të mos ishte fisi yt, do të të gurëzonim dhe ti nuk do të na mundje dot.”

93. Ai tha: “O populli im! Pse, fisi im është më i fuqishëm për ju sesa Allahu dhe ju e keni lënë Atë pas

قَالُوا لَشَعِيبُ أَبْصَلُوكُمْ تَأْمُرُكَ أَنْ تَتْرَكَ  
مَا يَعْْبُدُ آبَاؤُنَا أَوْ أَنْ نَفْعَلَ فِي أَمْوَالِنَا  
مَا نَشَاءُ إِنَّكَ لَأَنْتَ الْحَلِيمُ الرَّشِيدُ ﴿٨٨﴾

قَالَ يَقَوْمِ أَرَأَيْتُمْ إِنْ كُنْتُمْ عَلَى بَيِّنَةٍ  
مِنْ رَبِّي وَرَزَقْنِي مِنْهُ رِزْقًا حَسَنًا وَمَا  
أُرِيدُ أَنْ أَخَالِفُكُمْ إِلَىٰ مَا أَنْهَكُم عَنْهُ  
إِنْ أُرِيدُ إِلَّا الْإِصْلَاحَ مَا اسْتَطَعْتُ  
وَمَا تَوْفِيقِي إِلَّا بِاللَّهِ عَلَيْهِ تَوَكَّلْتُ  
وَإِلَيْهِ أُنِيبُ ﴿٨٩﴾

وَيَقَوْمِ لَا يَجْرِمَنَّكُمْ شِقَاقِي أَنْ يُصِيبَكُمْ  
مِثْلَ مَا أَصَابَ قَوْمَ نُوحٍ أَوْ قَوْمَ هُودٍ  
أَوْ قَوْمَ صَالِحٍ وَمَا قَوْمُ لُوطٍ مِنْكُمْ  
بِعِيدٍ ﴿٩٠﴾

وَاسْتَغْفِرُوا رَبَّكُمْ ثُمَّ تُوبُوا إِلَيْهِ إِنَّ رَبِّي  
رَحِيمٌ وَدُودٌ ﴿٩١﴾

قَالُوا لَشَعِيبُ مَا نَفَقَهُ كَثِيرًا مِمَّا تَقُولُ  
وَإِنَّا لَنَرَاكَ فِينَا ضَعِيفًا وَلَوْلَا رَهْطُكَ  
لَرَجَمْنَاكَ وَمَا أَنْتَ عَلَيْنَا بِعَزِيزٍ ﴿٩٢﴾

قَالَ يَقَوْمِ أَرَهْطِيَّ أَعَزُّ عَلَيْكُمْ مِنَ اللَّهِ  
وَآتَخَذْتُمُوهُ وَرَاءَكُمْ ظَهْرِيًّا إِنَّ رَبِّي بِمَا

shpine, si të braktisur! Sigurisht, Zoti im ia ka vënë rrethin asaj që bëni ju.

تَعْلَمُونَ مُحِيطٌ ﴿١٧﴾

94. Dhe o populli im! Bëni në vendin tuaj gjithçka që mundeni, edhe unë do të bëj (diçka). Së shpejti do të mësoni (se) kë do të zërë ndëshkimi që do ta poshtërojë atë, dhe (ju do ta kuptoni se) kush është gënjeshtari. Prisni, edhe unë bashkë me ju pres.”

وَيَقَوْمِ اعْمَلُوا عَلَىٰ مَكَانَتِكُمْ إِنِّي عَامِلٌ ۗ<sup>ط</sup>  
سَوْفَ تَعْلَمُونَ ۗ<sup>ل</sup> مَنْ يَأْتِيهِ عَذَابٌ يُخْزِيهِ  
وَمَنْ هُوَ كَاذِبٌ ۗ<sup>ط</sup> وَارْتَقِبُوا إِنِّي مَعَكُمْ  
رَقِيبٌ ﴿١٤﴾

95. E kur erdhi vendimi Ynë, shpëtuam Shuajbin si dhe ata që besuan bashkë me të, përmes mëshirës prej Nesh. Kurse ata që ishin keqbërës, i zuri krisma, aq sa që ata mbetën të gjunjësuar nëpër shtëpitë e tyre,

وَلَمَّا جَاءَ أَمْرُنَا نَجَّيْنَا شُعَيْبًا وَ الَّذِينَ  
آمَنُوا مَعَهُ بِرَحْمَةٍ مِنَّا وَأَخَذَتِ الَّذِينَ  
ظَلَمُوا الصَّيْحَةَ فَأَصْبَحُوا فِي دِيَارِهِمْ  
جُثَمِينَ ﴿١٥﴾

96. sikur nuk kishin ekzistuar në to. Dëgjoni! U shkatërrroshin medjenët, siç u shkatërruan themudët!

كَانَ لَمْ يَعْنُوا فِيهَا إِلَّا بَعْدًا لِّمَدْيَنَ  
كَمَا بَعَدَتْ ثَمُودُ ﴿١٦﴾

97. Sigurisht, dërguam edhe Musain me shenjat Tona dhe me argumente të qarta,

وَلَقَدْ أَرْسَلْنَا مُوسَىٰ بِآيَاتِنَا وَسُلْطٰنٍ  
مُّبِينٍ ﴿١٧﴾

98. drejt Faraonit dhe parisë së tij. Ata e ndoqën urdhrin e Faraonit. Dhe urdhri i Faraonit nuk ishte i udhës.

إِلَىٰ فِرْعَوْنَ وَمَلَئِهِ فَاتَّبَعُوا أَمْرَ فِرْعَوْنَ ۗ<sup>ج</sup>  
وَمَا أَمْرُ فِرْعَوْنَ بِرَشِيدٍ ﴿١٨﴾

99. Ai do ta prijë popullin e tij Ditën e Kiametit dhe do t'i shpjerë në zjarr. Sa i keq është moçali ku do të çohen ata!

يَقْدِمُ قَوْمَهُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ فَأَوْرَدَهُمُ النَّارَ ۗ<sup>ط</sup>  
وَبِئْسَ الْوَرْدُ الْمَوْرُودُ ﴿١٩﴾

100. Ata i ndoqi një mallkim edhe në këtë (botë), edhe në Ditën e Kiametit. Sa e keqe është “dhurata” që do t'u jepet!

وَأَسْمَعُوا فِي هَذِهِ لَعْنَةً ۗ<sup>ط</sup> وَ يَوْمَ الْقِيَامَةِ  
بِئْسَ الرَّفْدُ الْمَرْفُودُ ﴿٢٠﴾

101. Ky është (një) nga lajmet e vendbanimeve që të rrëfejmë ty. Disa prej tyre vijojnë të qëndrojnë, disa janë korrur.

ذٰلِكَ مِنْ اَنْبَاءِ الْقُرٰى نَقَّصْنٰهُ عَلَيْكَ مِنْهَا قٰٓئِمًا وَّ حٰصِدًا ﴿١٠١﴾

102. Dhe Ne nuk u kemi bërë keq atyre, përkundrazi, ata i bënë keq vetvetes. Pra, kur erdhi vendimi i Zotit tënd, të adhuruarit e tyre aspak nuk i shpëtuan dot ata, të cilët u luteshin në vend të Allahut. Madje, ata ua shtuan vetëm shkatërrimin.

وَمَا ظَلَمْنٰهُمْ وَلٰكِنْ ظَلَمُوْا اَنْفُسَهُمْ فَمَا اَغْنَتْ عَنْهُمْ اٰلِهَتُهُمُ الَّتِي يَدْعُوْنَ مِنْ دُوْنِ اللّٰهِ مِنْ شَيْءٍ لَّمَّا جَآءَ اَمْرٌ رَّبِّكَ ؕ وَمَا زَادُوْهُمْ غَيْرَ تَتٰبٍ ﴿١٠٢﴾

103. Kështu është kapja e Zotit tënd; Ai i kap vendbanimet kur ato janë keqbërëse. Njëmend, kapja e Tij është e dhimbshme, e fortë.

وَكَذٰلِكَ اَخَذَ الرَّبُّ اِذَا اَخَذَ الْقُرٰى وَهِيَ ظٰلِمَةٌ اِنَّ اَخْذَةَ اَلَيْمٌ شَدِيْدٌ ﴿١٠٣﴾

104. Sigurisht, në këtë ka shenjë për atë që i frikësohet ndëshkimit të *ahiretit*. Kjo është (një) ditë për të cilën do të mbliidhen njerëzit dhe kjo është ditë e dëshmuar.

اِنَّ فِيْ ذٰلِكَ لٰاٰيَةً لِّمَنْ خَافَ عَذَابَ الْاٰخِرَةِ ؕ ذٰلِكَ يَوْمٌ مَّجْمُوْعٌ لِّهٖ النَّاسُ وَذٰلِكَ يَوْمٌ مَّشْهُوْدٌ ﴿١٠٤﴾

105. Dhe Ne nuk e spostojmë atë, përveçse deri në një afat të caktuar.

وَمَا نُوَخِّرُهُ اِلَّا لِاَجَلٍ مَّعْدُوْدٍ ﴿١٠٥﴾

106. Ditën kur nuk flet asnjë shpirt pa lejen e Tij. Prej tyre do të ketë edhe fatzi, edhe fatbardhë.<sup>14</sup>

يَوْمَ يٰٓاْتِ لَا تَكَلِّمُ نَفْسٌ اِلَّا بِاِذْنِهٖ ؕ فَمَنْهُمْ سٰٓئِقٌ وَّ سٰٓعِيْدٌ ﴿١٠٦﴾

14. Njeriu që merr shumë pak nga bekimet Hyjnore, në terminologjinë e Kuranit, është quajtur fatzi. Kurse ai që merr shumë bekime Hyjnore është quajtur fatbardhë. Zoti në Librin e Tij të Shenjtë kështu i ka kategorizuar njerëzit, pra “fatbardhë dhe fatzinj”, dhe jo “të bukur e të shëmtuar”. Arsyeja është që askush nuk quhet i shëmtuar, pasi është krijuar nga Vetë Zoti. Pra, Zoti i krijoi njerëzit vetëm të bukur. Po, të bukurit karakterizohen në bazë të asaj çfarë kanë fituar nga bekimet e Zotit. Fatbardhi nuk nxitohet, nuk paragjykon, duron dhe përfundimisht beson. Kurse fatziu nxitohet dhe fillon të akuzojë të vërtetën.

107. Ata që do të dalin fatzinj, do të jenë në zjarr. Në të do të kenë britmë e piskamë.

فَأَمَّا الَّذِينَ شَقُوا فِيهِ النَّارِ لَهُمْ فِيهَا  
زَفِيرٌ وَشَيْقٌ ﴿١٠٧﴾

108. Në të do të qëndrojnë, gjersa të rrojnë qiejt e toka, përveç asaj që do Zoti yt. Sigurisht, Zoti yt e bën atë që dëshiron.

حُلِدِينَ فِيهَا مَا دَامَتِ السَّمَوْتُ وَالْأَرْضُ  
إِلَّا مَا شَاءَ رَبُّكَ ۗ إِنَّ رَبَّكَ فَعَّالٌ لِّمَا  
يُرِيدُ ﴿١٠٨﴾

109. Kurse ata që dalin fatbardhë, do të jenë në xhenet. Në të do të qëndrojnë, gjersa të rrojnë qiejt e toka, përveç asaj që do Zoti yt; një shpërblim pambarim.<sup>15</sup>

وَأَمَّا الَّذِينَ سَعَدُوا فِيهِ الْجَنَّةِ حُلِدِينَ  
فِيهَا مَا دَامَتِ السَّمَوْتُ وَالْأَرْضُ إِلَّا مَا  
شَاءَ رَبُّكَ ۗ عَطَاءٌ غَيْرَ مَجْدُوذٍ ﴿١٠٩﴾

110. Andaj, mos ji në dyshim ndaj asaj që ata adhurojnë. Ata adhurojnë njëlloj sikur adhuronin etërit e tyre më përpara. Sigurisht, Ne do t'ua kthejmë të plotë pjesën e tyre, pa pakësim.

فَلَا تَكُ فِي مَرِيَةٍ مِّمَّا يَعْبُدُ هَؤُلَاءِ ۗ مَا  
يَعْبُدُونَ إِلَّا كَمَا يَعْبُدُ آبَاؤَهُمْ مِّنْ  
قَبْلُ ۗ وَإِنَّا لَمَوْفُوهُم نَصِيبَهُمْ غَيْرَ  
مَنْقُوصٍ ﴿١١٠﴾

111. Edhe Musait i dhamë Librin dhe (edhe) atë e kanë kundërshtuar. Sikur të mos ishte lëshuar (një) fjalë paraprake prej Zotit tënd, do të ishte

وَلَقَدْ آتَيْنَا مُوسَى الْكِتَابَ فَاحْتَلَفَ فِيهِ ۗ  
وَلَوْ لَا كَلِمَةٌ سَبَقَتْ مِنْ رَبِّكَ لَقَضَىٰ

15. Ajetet: 108-109: Në përshkrimin e xhenetit dhe të xhehenemit, ajetet përkatëse pasi tregojnë se sa do të qëndrojnë banorët aty, pohojnë: “përveç asaj që do Zoti yt”. Megjithatë, për xhehenemin, ajeti e mbyll temën me këto fjalë, kurse për xhenetin, fjalët vijnë “një shpërblim pambarim”. Ne besojmë se shpirttrave njerëzorë do t’u vijë një kohë kur edhe ai që ishte fatzi në popullin e tij, do të përmirësohet dhe do të mëshirohet prej Zotit. Andaj, njerëzit e ligj do të qëndrojnë në xhehenem për një kohë të gjatë, por jo pa mbarim. Se sa e gjatë do të jetë kjo kohë, Zoti nuk na ka dhënë dijëni për këtë, andaj, nuk mund të përcaktojmë ne kohëzgjatjen e saj. Po, nisur nga imagjinata e dobët njerëzore, ajo periudhë quhet “e përhershme”, por në Sy të Zotit, ajo e ka një kufi. Banorët e xhehenemit nuk do të lihen “të verbër” dhe “fatzinj” përgjithmonë. Pas kurimit tejet të mundimshëm në xhehenem, mëshira e Zotit përfundimisht do t’i përfshijë edhe ata. Pra, përjetësia e xhehenemit nuk është e ngjashme me përjetësinë e Zotit, përkundrazi, çdo ndëshkim e ka një kufi dhe çdo mallkim mbizotërohet nga mëshira. Sigurisht, Allahu është më i Mëshirshmi nga të gjithë mëshiruesit. Thuhet edhe në një hadith: “Xhehenemit patjetër do t’i vijë një kohë, kur kanatet e portave të tij do të përplasen, kur nuk do të ketë njeri në të.” (Taberiu, 11:107). Më shumë rreth kësaj teme, lexoni 78:24.

vendosur për ta. Në lidhje me këtë, ata janë në një dyshim shqetësues.

112. Dhe Zoti yt do t'ua kthejë atyre të gjithëve veprat plotësisht. Sigurisht, Ai është i Gjithinformuar për atë që ata bëjnë.

113. Andaj, qëndro ashtu siç je urdhëruar ti, gjithashtu dhe ai që u pendua bashkë me ty, dhe mos e kaloni kufirin. Sigurisht, Ai është i Gjithinformuar për atë që bëni.

114. Mos anoni nga ata që bënë të këqija, sepse do t'ju prekë zjarri (edhe ju), dhe nuk do të keni dot asnjë kujdestar përveç Allahut, më pas nuk do të ndihmoheni.

115. Fal namazin në të dyja skajet e ditës dhe në disa pjesë të natës. Sigurisht, të mirat i largojnë të këqijat. Kjo është një këshillë për ata që këshillojnë.

116. Duro, sepse Allahu nuk ua humb shpërblimin mirëbërësve.

117. Përse atëherë nuk pati në kohërat para jush njerëz të mençur që të ndalonin trazirën në tokë, përveç të paktëve prej tyre që Ne i shpëtuan?! Ata që bënë të këqija, ndoqën pikërisht atë për të cilën (të parët e tyre) u cilësuan rebelë. Ata ishin fajtorë.

بَيْنَهُمْ ۖ وَآلَهُمْ لَفِي شَكٍّ مِّنْهُ مُرِيبٌ ﴿١١١﴾

وَإِنَّ كَلَامًا لَّمَّا يَوْفِيهِهُمْ رَبُّكَ أََعْمَالَهُمْ ۖ  
إِنَّهُ بِمَا يَعْمَلُونَ خَبِيرٌ ﴿١١٢﴾

فَأَسْتَقِمْ كَمَا أَمَرْتُ وَمَنْ تَابَ مَعَكَ  
وَلَا تَطْغَوْا ۗ إِنَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ بَصِيرٌ ﴿١١٣﴾

وَلَا تَرْكَبُوا إِلَى الَّذِينَ ظَلَمُوا فَمَا تَمَسَّكُمْ  
النَّارُ ۗ وَمَا لَكُمْ مِّنْ دُونِ اللَّهِ مِنْ أَوْلِيَاءَ  
ثُمَّ لَا تَنْصُرُونَهُ ﴿١١٤﴾

وَاقِمِ الصَّلَاةَ طَرَفِي النَّهَارِ وَرُفْعًا مِّنَ  
الْأَيْلِ ۗ إِنَّ الْحَسَنَاتِ يُدْهَبْنَ السَّيِّئَاتِ ۗ ذَلِكَ  
ذِكْرِي لِلذَّكْرَيْنِ ﴿١١٥﴾

وَاصْبِرْ فَإِنَّ اللَّهَ لَا يُضِيعُ أَجْرَ  
الْمُحْسِنِينَ ﴿١١٦﴾

فَلَوْ لَا كَانَ مِنَ الْقُرُونِ مِنْ قَبْلِكُمْ  
أُولُو بَيْتَاتٍ يَبْتَغُونَ عَنِ الْفَسَادِ فِي الْأَرْضِ  
إِلَّا قَلِيلًا مِّمَّنْ أَنْجَيْنَا مِنْهُمْ ۗ وَاتَّبَعَ  
الَّذِينَ ظَلَمُوا مَا أُتْرِفُوا فِيهِ وَكَانُوا  
مُجْرِمِينَ ﴿١١٧﴾

118. Zoti yt nuk është i tillë që i shkatërron vendbanimet, kur banorët e tyre janë duke bërë përmirësime.

وَمَا كَانَ رَبُّكَ لِيُهْلِكَ الْقُرَىٰ بِظُلْمٍ  
وَأَهْلِهَا مُصْلِحُونَ ﴿١١٨﴾

119. Po të donte Zoti yt, do t'i bënte njerëzit një popull të vetëm, por ata gjithmonë do të kundërshtojnë.

وَلَوْ شَاءَ رَبُّكَ لَجَعَلَ النَّاسَ أُمَّةً وَاحِدَةً  
وَلَا يَرَالُونَ مُخْتَلِفِينَ ﴿١١٩﴾

120. Përveç atij që mëshiron Zoti yt, dhe për këtë Ai i krijoi ata. U plotësua edhe fjala e Zotit tënd: Unë përnjëmend do ta mbush xhehenemin nga xhindët dhe njerëzit që të gjithë.

إِلَّا مَنْ رَحِمَ رَبُّكَ ۗ وَلِذَلِكَ خَلَقَهُمْ  
وَتَمَّتْ كَلِمَةُ رَبِّكَ لَأَمْلَأَنَّ جَهَنَّمَ مِنَ  
الْجِنَّةِ وَالنَّاسِ أَجْمَعِينَ ﴿١٢٠﴾

121. Gjithçka që të rrëfejmë ty prej lajmeve të të Dërguarve është që të ta forcojmë zemrën. Dhe në këtë (rrëfim) ty të erdhi e vërteta, një këshillë, dhe kujtesë për besimtarët.<sup>16</sup>

وَكَلَّا تَقْصُصَ عَلَيْكَ مِنْ أَنْبَاءِ الرُّسُلِ مَا  
نُنِيتُ بِهِ فُؤَادَكَ ۗ وَجَاءَكَ فِي هَذِهِ  
الْحَقُّ وَمَوْعِظَةٌ وَذِكْرَىٰ لِلْمُؤْمِنِينَ ﴿١٢١﴾

122. Thuaju atyre që nuk besojnë: “Veproni në vendin tuaj! Edhe ne do të veprojme.

وَقُلْ لِلَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ أَعْمَلُوا عَلَىٰ  
مَكَانَتِكُمْ ۗ إِنَّا عَمِلُونَ ﴿١٢٢﴾

123. Prisni, edhe ne jemi duke pritur.”

وَانظُرُوا ۗ إِنَّا مُنْتَظِرُونَ ﴿١٢٣﴾

124. E Allahut është e padukshmja e qiejve dhe e tokës dhe tek Ai kthehet e gjithë çështja, andaj, Atë adhuroje dhe Atij mbështetju! Zoti yt nuk është i pavëmendshëm ndaj asaj që bëni.

وَاللَّهُ غَيْبِ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَإِلَيْهِ  
يُرْجَعُ الْأَمْرُ كُلُّهُ فَاعْبُدْهُ وَتَوَكَّلْ  
عَلَيْهِ ۗ وَمَا رَبُّكَ بِعَافِلٍ عَمَّا تَعْمَلُونَ ﴿١٢٤﴾

16. Kurani u quajt kujtesë (arab. *dhikr*), sepse ai i kujton njeriut “librin” e tij të brendshëm, “librin” që gjendet në ndërgjegjen e tij. Në këtë aspekt, Kurani nuk solli ndonjë mësim të ri, por i kujtoi njeriut aftësitë dhe normat që ishin të fshehura tek ai. Vetëpërmbajtja, sakrifica, guximi, forca, zemërimi, vetëmjaftueshmëria etj.. të gjitha këto janë aftësi që gjenden në natyrën e njeriut. E Kurani ia kujtoi ato. Siç thuhet edhe në një ajet tjetër që Kurani është “(i ruajtur) në një Libër të fshehtë” (56:79). Kështu që, kur njeriu e studion me vëmendje këtë Libër, do t’i kujtojë aftësitë e tij morale dhe shpirtërore, si dhe dritën e tij të zemrës që i ka dhuruar Vetë Krijuesi.

## Surja 12 – Jusuf

Surja Jusuf është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka njëqind e dymbëdhjetë ajete.

Sikurse e mëparshmja, edhe kjo sure fillon me shkurtesat *elif-lam-ra*, që kanë të njëjtin kuptim që e thamë më përpara.

Menjëherë pas shkurtesave, fillon më i bukuri prej *tregimeve* që do t'ia këndellte zemrën Profetit Muhammed<sup>savs</sup>. Kjo do të ishte zgjidhja më e mirë e brengosjes që i shkaktoi surja Hud. Këtu është e nevojshme të sqarohet se fjala *kasas* nuk do të thotë përrallë, por janë histori të së kaluarës, të cilat vërtetohen pasi të gjurmohen.

Surja fillon me një ëndërr të *Hazret Jusufit*<sup>as</sup>, e cila parashikonte gjithçka që do t'i ndodhte në të ardhmen, interpretimin e së cilës do t'ia tregonte babai i tij, *Hazret Jakubi*<sup>as</sup>. Sipas këtij interpretimi, ai e paralajmëroi Jusufin<sup>as</sup> për një rrezik të madh që do t'i vinte nga vëllezërit e tij, andaj, e porositi të mos ua tregonte ëndrrën.

E gjithë surja trajton dijen e interpretimit të ëndrrave që i ishte dhuruar Jusufit<sup>as</sup>. *Hazret Jusufi* kishte dy shokë burgu, të cilët shohin nga një ëndërr. Jusufi ua tregon interpretimin që njeri do të vdiste dhe tjetri do të shpëtonte. Interpretimi për të dy përmbushet fjalë për fjalë. Ai që shpëtoi, u bë shkak që *Hazret Jusufi*<sup>as</sup> ta interpretonte ëndrrën e mbretit, ëndërr të cilën oborrtarët e kishin komentuar si ëndërr që tregon mendja (*nefsi*). Ishte pikërisht interpretimi i *Hazret Jusufit* për ëndrrën e mbretit që u bë shkak që njerëzit e varfër të perandorisë të shpëtonin nga skamja, të cilët për shtatë vite thatësire me radhë patën rezerva ushqimi, që nëse u mungonin, ata do të vdisnin urie. Vetë *Hazret Jusufi* u caktua si organizator i këtij mbarështimi. Për këtë arsye, përfundimisht, prindërit dhe vëllezërit e tij vijnë tek ai për të kërkuar strehë dhe i bënë sexhden Allahut për shenjat dhe mirësitë që panë përmes *Hazret Jusufit*<sup>as</sup>.

Këto ngjarje të historisë, Profeti Muhammed<sup>savs</sup> vetë nuk mund t'i dinte në asnjë mënyrë. Andaj, Kurani tha: Ti nuk ke qenë mes tyre kur po ndodhte e gjithë kjo, por Allahu, i Gjithëdijsmi dhe i Gjithinformuari, t'i tregon këto ngjarje.

Surja përfundon me pohimin se këto ngjarje nuk janë thjesht tregime prej ndonjë përrallëtari, por njerëzit e mençur kanë plot mësimë në to. Pa dyshim, surja Jusuf na tërheq vëmendjen për mësimë të shumta.





1. Me emrin e Allahut, të Gjithë-mëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. *Elif.Lam.Ra.* (Unë jam Allahu që shoh.) Këto janë ajetet e Librit të qartë.

الرَّكَعِ تِلْكَ آيَاتِ الْكِتَابِ الْمُبِينِ ②

3. Sigurisht, Ne e kemi zbritur këtë si Kuran në arabisht, që ju të mendoheni.

إِنَّا أَنْزَلْنَاهُ قُرْآنًا عَرَبِيًّا لَعَلَّكُمْ تَعْقِلُونَ ③

4. Përmes këtij Kurani që të shpallëm ty, Ne të tregojmë ndodhitë më të bukura, edhe pse ti (në lidhje me to) deri para kësaj, ishe ndër të paditurit.

نَحْنُ نَقُصُّ عَلَيْكَ أَحْسَنَ الْقَصَصِ بِمَا أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ هَذَا الْقُرْآنَ وَإِنْ كُنْتَ مِنْ قَبْلِهِ لَمَنِ الْغٰفِلِينَ ④

5. Kur Jusufi i tha babait të tij: “O babai im! Kam parë (në ëndërr) njëmbëdhjetë yje, diellin dhe hënën. I kam parë që ato kishin rënë në sexhde për mua.”

إِذْ قَالَ يُوسُفُ لِأَبِيهِ يَا أَبَتِ إِنِّي رَأَيْتُ أَحَدَ عَشَرَ كَوْكَبًا وَالشَّمْسَ وَالْقَمَرَ رَأَيْتُهُمْ لِي سَجْدِينَ ⑤

6. Ai tha: “O biri im! Mos e trego ëndrrën tënde para vëllezërve të tu,<sup>1</sup> se ata do të kurdisin ndonjë plan kundër teje. Njëmend, djalli për njeriun është një armik i hapur.

قَالَ يَبْنَىٰ لَا تَقْصُصْ رُءْيَاكَ عَلٰى إِخْوَتِكَ فَيَكِيدُوا لَكَ كَيْدًا إِنَّ الشَّيْطَانَ لِلْإِنْسَانِ عَدُوٌّ مُّبِينٌ ⑥

7. Po kështu, Zoti yt do të të zgjedhë ty, do të të japë dijen për të kuptuar realitetin e çështjeve, do të plotësojë bekimin e Tij për ty dhe për familjen e Jakubit, ashtu siç e plotësoi atë më parë për baballarët e tu, Ibrahimin dhe Is'hakun. Sigurisht, Zoti yt është i Gjithëdijshëm, i Urtë.”

وَكَذٰلِكَ يَجْتَبِيْكَ رَبُّكَ وَيُعَلِّمُكَ مِنْ تٰوِيلِ الْاَحَادِيْثِ وَيُؤْتِيْكَ نِعْمَتَهٗ عَلَيْكَ وَعَلٰى اٰلِ يٰعْقُوْبَ كَمَا اٰتَمَّهَا عَلٰى اٰبَوٰيكَ مِنْ قَبْلُ اِبْرٰهِيْمَ وَاِسْحٰقَ ۗ اِنَّ رَبَّكَ لَعَلِيْمٌ حَكِيْمٌ ⑦

1. Emrat e tyre sipas Biblës, lexoni te 2:137.

8. Pa dyshim, në (ngjarjen e) Jusufit dhe të vëllezërve të tij ka shenja për kërkimtarët.

لَقَدْ كَانَ فِي يُوسُفَ وَإِخْوَتِهِ آيَاتٍ  
لِّلسَّالِفِينَ ﴿٨﴾

9. Kur (vëllezërit) thanë: “Jusufi dhe vëllai i tij me të vërtetë janë më të dashur për babanë tonë sesa ne, edhe pse ne jemi një grup i fortë. Babai ynë është në një gabim të qartë.

إِذْ قَالُوا لِيُوسُفَ وَأَخُوهُ أَحَبُّ إِلَيْنَا  
مِمَّا وَنَحْنُ عُصْبَةٌ ۗ إِنَّ آبَانَا لَفِي ضَلَالٍ  
مُّبِينٍ ﴿٩﴾

10. Vriteni Jusufin ose flakeni diku në një vend, që vëmendja e babait tuaj t’ju sigurohet vetëm juve dhe pas asaj të bëheni njerëz të dëlirë.”

اقْتُلُوا يُوسُفَ أَوْ اطْرَحُوهُ أَرْضًا يَبْحَثُ  
لَكُمْ وَجْهٌ أَبِيكُمْ وَتَكُونُوا مِنْ بَعْدِهِ  
قَوْمًا صَالِحِينَ ﴿١٠﴾

11. Njëri prej tyre tha: “Mos e vritni Jusufin, por nëse doni të bëni diçka, hidhjeni në thellësitë e pusit, që atë ta marrë ndonjë karvan.”

قَالَ قَائِلٌ مِمَّهُمْ لَا تَقْتُلُوا يُوسُفَ  
وَأَلْقُوهُ فِي غِيَابِ الْجُبِّ يَلْتَقِطُهُ  
بَعْضُ السَّيَّارَةِ إِنْ كُنْتُمْ فَاعِلِينَ ﴿١١﴾

12. Thanë: “O babai ynë! Përse nuk na beson për Jusufin, ndërkohë jemi dashamirës të tij.

قَالُوا يَا أَبَانَا مَا لَكَ لَا تَأْمَنَّا عَلَى يُوسُفَ  
وَإِنَّا لَهُ لَنَصِحُونَ ﴿١٢﴾

13. Dërgoje atë me ne nesër, që të hajë dhe të luajë dhe, sigurisht, ne për të jemi mbrojtës.”

أَرْسَلَهُ مَعَنَا عَدَا يَرْتَع وَيَلْعَبُ وَإِنَّا لَهُ  
لَحَفِظُونَ ﴿١٣﴾

14. Ai tha: “Mua vërtet më shqetëson që ju ta merrni atë dhe kam frikë se të mos e hajë ujku, kur ju të jeni të pavëmendshëm ndaj tij.”

قَالَ إِنِّي لَيَحْزُنُنِي أَنْ تَذَهَبُوا بِهِ  
وَأَخَافُ أَنْ يَأْكُلَهُ الذِّبُّ وَأَنْتُمْ عَنْهُ  
غٰفِلُونَ ﴿١٤﴾

15. Ata thanë: “Po ta hajë atë ujku, edhe pse jemi një grup i fortë, sigurisht që do të jemi ne humbës!”

قَالُوا لَئِنْ أَكَلَهُ الذِّبُّ وَنَحْنُ عُصْبَةٌ إِنَّا  
إِذَا لَخَسِرُونَ ﴿١٥﴾

16. Andaj, kur ata e morën dhe ranë në ujdi që ta hidhnin atë në thellësitë e pusit, Ne i shpallëm (Jusufit): “Ti do t’ua tregosh këtë punë të tyre (një ditë), ndërkohë ata nuk do ta kuptojnë fare (se kush je).”

فَلَمَّا ذَهَبُوا بِهِ وَاجْمَعُوا أَنْ يَجْعَلُوهُ فِي  
عَيْبَتِ الْجُبِّ ۚ وَأَوْحَيْنَا إِلَيْهِ لَتُنَبِّئَهُمْ  
بِأَمْرِهِمْ هَذَا وَهُمْ لَا يَشْعُرُونَ ﴿١٦﴾

17. Dhe ata u kthyen natën te babai i tyre duke qarë.

وَجَاءَ وَوَأَبَاهُمْ عِشَاءً يَبْكُونَ ﴿١٧﴾

18. Thanë: “O babai ynë! Tek po garonim, u larguam dhe e lamë Jusufin te plaçkat tona, atë e hëngri ujku. Ti nuk do të na besosh, edhe pse themi të vërtetën.”

قَالُوا يَا أَبَانَا إِنَّا ذَهَبْنَا نَسْتَقِ وَيُتْرَكْنَا  
يُوسُفَ عِنْدَ مَتَاعِنَا فَأَكَلَهُ الذِّئْبُ ۚ وَمَا  
أَنْتَ بِمُؤْمِنٍ لَّنَا وَلَوْ كُنَّا صَادِقِينَ ﴿١٨﴾

19. Ata gjithashtu sollën këmishën e tij me gjak të rremë. Ai tha: “Përkundrazi, vetja juaj ju ka bërë të lehtë një çështje (të rëndë). Andaj, (s’më mbetet veçse) durim i denjë! Vetëm Allahut mund t’i kërkohej ndihmë për atë që tregoni.”

وَجَاءَ وَعَلَى قَيْمِصِهِ بِدَمٍ كَذِبٍ ۚ قَالَ بَلْ  
سَوَّلَتْ لَكُمْ أَنْفُسُكُمْ أَمْراً ۚ فَصَبْرٌ  
جَبِيلٌ ۗ وَاللَّهُ الْمُسْتَعَانُ عَلَى مَا  
تَصِفُونَ ﴿١٩﴾

20. Erdhi një karvan, dërguan njërin prej tyre për të mbushur ujë dhe ai e hodhi kovën e tij. Tha: “Lajm i mirë! Paska një djalë!” Dhe ata e fshehën sikur (të ishte) një pasuri. Allahu e dinte shumë mirë se çfarë bënin ata.

وَجَاءَتْ سَيَّارَةٌ فَأَرْسَلُوا وَارِدَهُمْ فَأَدْلَى  
دَلْوَهُ ۗ قَالَ يَبْنَؤُا هَذَا غُلْمٌ ۚ وَأَسْرُوهُ  
بِضَاعَةٍ ۗ وَاللَّهُ عَلِيمٌ بِمَا يَعْمَلُونَ ﴿٢٠﴾

21. Dhe e shitën me një çmim të vogël, në këmbim të pak dirhemëve. Ata nuk tregonin interes për të.

وَأَسْرُوهُ بِثَمَنٍ بَخْسٍ دَرَاهِمَ مَعْدُودَةٍ ۚ  
وَكَانُوا فِيهِ مِنَ الزَّاهِدِينَ ﴿٢١﴾

22. Ai që e bleu në Egjipt, i tha gruas së vet: “Mbaje me nderim, ndoshta do të na sjellë dobi ose do ta marrim për bir.” E kështu Ne i siguruam Jusufit një vend në tokë, që t’i japim dijen

وَقَالَ الَّذِي اشْتَرَاهُ مِنْ مِصْرَ لِامْرَأَتِهِ  
أَكْرِمِي مَثْوَاهُ عَسَى أَنْ يَتَّبِعُنَا أَوْ  
نَتَّخِذَهُ وَلَدًا ۗ وَكَذَلِكَ مَكَّنَّا لِيُوسُفَ فِي

për të kuptuar realitetin e çështjeve. Allahu triumfon në vendimin e Tij, por shumica e njerëzve nuk e dinë.<sup>2</sup>

23. Kur ai arriti pjekurinë, i dhamë urtësinë dhe dijen. Ne kështu shpërblejmë mirëbërësit.<sup>3</sup>

24. Zonja e shtëpisë ku ishte ai, tentoi ta joshte atë kundër dëshirës së tij; mbylli dyert dhe i tha: “Më eja!” Ai tha: “Më mbrojtë Allahu! Zoti im është Ai që më siguroi një strehë të mirë. Sigurisht, keqbërësit nuk kanë sukses.”

25. Njëmend, ajo iu dha plotësisht atij, edhe ai do t'i jepej plotësisht asaj, po të mos kishte parë provën e Zotit të tij.<sup>4</sup> Kështu bëmë që ta largonim atë nga ligësia dhe paturpësia. Sigurisht, ai ishte prej robërve Tanë të zgjedhur.

26. Ata të dy iu vërsulën derës dhe ajo ia grisi këmishën nga mbrapa, dhe gjetën burrin e saj te dera. Ajo i

الْأَرْضِ وَنُعَلِّمُهُ مِنْ تَأْوِيلِ الْأَحَادِيثِ<sup>ط</sup>  
وَاللَّهُ غَالِبٌ عَلَى أَمْرِهِ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ

النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٣١﴾

وَلَمَّا بَلَغَ أَشُدَّهُ آتَيْنَاهُ حُكْمًا وَعِلْمًا<sup>ط</sup>  
وَكَذَلِكَ نَجْزِي الْمُحْسِنِينَ ﴿٣٢﴾

وَرَأَوْنَاهُ أَتَىٰ هُوَ فِي بَيْتِهَا عَنْ نَفْسِهِ<sup>ط</sup>  
وَعَلَّقَتِ الْأَبْوَابَ وَقَالَتْ هَيْتَ لَكَ<sup>ط</sup>  
قَالَ مَعَاذَ اللَّهِ إِنَّهُ رَبِّي أَحْسَنَ مَثْوَايَ<sup>ط</sup>  
إِنَّهُ لَا يَفْلِحُ الظَّالِمُونَ ﴿٣٣﴾

وَلَقَدْ هَمَّتْ بِهِ<sup>ع</sup> وَهَمَّ بِهَا لَوْلَا أَنْ رَأَىٰ<sup>ط</sup>  
بُرْهَانَ رَبِّهِ<sup>ط</sup> كَذَلِكَ لِنَصْرِفَ عَنْهُ السُّوءَ  
وَالْفَحْشَاءَ<sup>ط</sup> إِنَّهُ مِنْ عِبَادِنَا الْمُخْلَصِينَ ﴿٣٤﴾

وَأَسْتَبَقَا الْبَابَ وَقَدَّتْ قَمِيصَهُ مِنْ دُبُرٍ<sup>ط</sup>  
وَأَلْفَا سَيِّدَهَا لَدَا الْبَابِ<sup>ط</sup> قَالَتْ مَا جَزَاءُ

2. Egjiptasi që bleu Jusufin, në literaturën judaike, njihet me emrin Potifar, dhe ishte oficeri i Faraonit dhe kapiteni i rojeve (Enc. Bib. dhe Bibla, Zanafilla 39:1).

3. Me pjekurinë nuk nënkuptohet profetëria, por pjekuria në moshë. Një pjekuri është ajo që i sjell njeriut qëndrueshmëri në trup e në karakter, dhe një tjetër është ajo që i mundëson shpallje.

4. Fjalët “ai iu dha asaj” nuk nënkuptojnë se Hazret Jusufi<sup>as</sup> donte të hynte në mëkat, por këtë pjesë duhet ta lexojmë bashkë me pjesën vijuese “po të mos kishte parë provën e Zotit të tij”. Kjo do të thotë se edhe Jusufi do të bënte mëkat bashkë me të, po të mos kishte parë provën e Zotit të tij. Dhe provë nuk do të thotë se ai pikërisht në atë moment pa ndonjë mrekulli, siç përshkruajnë disa komentues të Kuranit, por bëhet fjalë për shenja të vazhdueshme që Allahu i Madhërisëm i ka treguar që nga fëmijëria e tij, aq sa që, Hazret Jusufi<sup>as</sup> kishte njohjen ndaj Zotit të Madhërisëm dhe nuk mund të bënte mëkat.

tha: “Çfarë dënimi ka ai që dëshiroi të keqe me zonjën tënde, përveçse të burgoset ose ndonjë ndëshkim të dhimbshëm?!”

27. (Jusufi) i tha: Ajo tentoi të më joshte kundër dëshirës sime.” Një dëshmitar prej njerëzve të shtëpisë dëshmoi: “Nëse këmisha e tij është grisur nga para, ajo e tha të vërtetën dhe ky është prej gënjeshtarëve.

28. Dhe nëse këmisha e tij është grisur nga mbrapa, ajo gënjeu dhe ky është prej të vërtetëve.”

29. E kur ai pa që këmisha i ishte grisur nga mbrapa, i tha (gruas së vet): “Me siguri, ky është kurthi juaj. Kurthi i ju grave është i rëndë!

30. O Jusuf! Shmangu nga kjo! Dhe ti (moj grua!) Kërko falje për mëkatin tënd; ti vërtet je prej fajtorëve.”

31. Gratë e qytetit thanë: “Gruaja e ministrit josh shërbëtorin e vet kundër dëshirës së tij. Ai i ka hyrë në zemër. Përnjëmend, atë e shohim në një gabim të qartë.”

32. E kur ajo dëgjoji intrigat e tyre, i thirri. U përgatiti një vend të rehatshëm për t’u ulur. Secilës prej tyre i dha nga një thikë dhe i tha (Jusufit): “Dil përpara tyre!” E kur ato e panë, e gjetën të hijshëm, prenë duart e veta dhe thanë: “Madhështia e Allahut! Ky nuk është njeri! Ky është vetëm një engjell fisnik!”

مَنْ أَرَادَ بِأَهْلِكَ سُوءًا إِلَّا أَنْ يُسْجَنَ  
أَوْ عَذَابٍ أَلِيمٍ ﴿٢٦﴾

قَالَ هِيَ رَأَوْتَنِي عَنْ نَفْسِي وَشَهِدَ شَاهِدٌ  
مِنْ أَهْلِهَا ۚ إِنْ كَانَ قَمِيصُهُ قُدًّا مِنْ قَبْلِ  
فَصَدَقْتَ وَهُوَ مِنَ الْكَاذِبِينَ ﴿٢٧﴾

وَإِنْ كَانَ قَمِيصُهُ قُدًّا مِنْ دُبُرٍ فَكَذَبْتَ  
وَهُوَ مِنَ الصَّادِقِينَ ﴿٢٨﴾

فَلَمَّا رَأَى قَمِيصَهُ قُدًّا مِنْ دُبُرٍ قَالَ إِنَّهُ مِنْ  
كَيْدِكُمْ ۗ إِنَّ كَيْدَكُمْ عَظِيمٌ ﴿٢٩﴾

يُوسُفُ أَعْرَضَ عَنْ هَذَا ۖ وَاسْتَغْفِرَ لِي  
لِدُنْيِكَ ۗ إِنَّكَ كُنْتَ مِنَ الْخَاطِئِينَ ﴿٣٠﴾

وَقَالَ نِسْوَةٌ فِي الْمَدِينَةِ امْرَأَتُ الْعَزِيزِ  
تُرَاوِدُ فَتَاهَا عَنْ نَفْسِهِ ۚ قَدْ شَغَفَهَا حُبًّا  
إِنَّا لَنَرَاهَا فِي ضَلَالٍ مُّبِينٍ ﴿٣١﴾

فَلَمَّا سَمِعَتْ بِمَكْرِهِنَّ أَرْسَلَتْ إِلَيْهِنَّ  
وَأَعْتَدَتْ لَهُنَّ مُتَّكًا ۖ وَآتَتْ كُلَّ وَاحِدَةٍ  
مِنْهُنَّ سِكِّينًا ۖ وَقَالَتِ اخْرُجْ عَلَيْهِنَّ ۚ  
فَلَمَّا رَأَيْنَهُ أَكْبَرْنَهُ وَقَطَّعْنَ أَيْدِيَهُنَّ  
وَقُلْنَ حَاشَ لِلَّهِ مَا هَذَا بَشَرًا ۗ إِنْ هَذَا  
إِلَّا مَلَكٌ كَرِيمٌ ﴿٣٢﴾

33. Ajo tha: “Ja, ky është ai për të cilin më qortoni. Unë e kam joshur kundër dëshirës së tij, por ai shpëtoi. E nëse nuk do ta bëjë atë që unë e urdhëroj, ai patjetër do të burgoset dhe do të bëhet ndër të poshtëruarit.”

قَالَتْ فَذَلِكُنَّ الَّذِي لُمْتُنَّنِي فِيهِ ۖ وَلَقَدْ رَاوَدْتُهُ عَنْ نَفْسِهِ فَاسْتَعْصَمَ ۖ وَلَئِن لَّمْ يَفْعَلْ مَا أَمَرُهُ لَيُصْجَبَنَّ وَيَكُونًا مِنَ الصَّغِيرِينَ ﴿٣٣﴾

34. Ai tha: “O Zoti im! Më shumë dua burgun sesa atë për të cilën ato më ftojnë. Dhe po nuk ma largove kurthin e tyre, unë do të anoj nga ato dhe do të bëhem nga injorantët!”<sup>5</sup>

قَالَ رَبِّ السِّجْنُ أَحَبُّ إِلَيَّ مِمَّا يَدْعُونَنِي إِلَيْهِ ۖ وَإِلَّا تَصْرِفْ عَنِّي كَيْدَهُنَّ أَصْبُ إِلَيْهِنَّ وَأَكُنَّ مِنَ الْجَاهِلِينَ ﴿٣٤﴾

35. Atëherë Zoti i tij ia dëgjoi lutjen dhe ia largoi kurthin e tyre. Sigurisht, Ai është Gjithëdëgjuesi, i Gjithëdijshmi.

فَاسْتَجَابَ لَهُ رَبُّهُ فَصَرَفَ عَنْهُ كَيْدَهُنَّ ۗ إِنَّهُ هُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ ﴿٣٥﴾

36. Pasi panë shenjat (e tjera) në vazhdim, atyre iu duk (e udhës) që duhet ta burgosnin për një kohë.

ثُمَّ بَدَأَهُمْ مِنْ بَعْدِ مَا رَأَوُا الْآيَاتِ ۚ لِيُصْجَبْنَ لَهُ حَتَّىٰ حِينٍ ﴿٣٦﴾

37. Bashkë me të, në burg hynë edhe dy djelmosha. Njëri prej tyre i tha: “E shoh veten (në ëndërr) duke

وَدَخَلَ مَعَهُ السِّجْنَ فَتَيَيْنِ ۖ قَالَ أَحَدُهُمَا إِنِّي أَرَانِي أَعَصِرُ خَمْرًا ۗ

5. Jusufi<sup>as</sup> u quajt “i vërtetë” (12:47), sepse tregoi vërtetësi të pakundshoqe. Një grua e re, e bukur dhe që vinte nga një familje e nderuar, i kërkon të bëjë imoralitet me të. Habitesh nga vërtetësia shpirtërore e tij që nuk desh të shkelte kufirin e vendosur prej Zotit, edhe sikur t’i kushtonte burgimin dhe ndëshkime të tjera të rënda. Andaj, nga kërcënimet e gruas në fjalë, Hazret Jusufi<sup>as</sup> iu lut Zotit – Më shumë dua burgun sesa atë për të cilën ato më ftojnë. Nuk përmendi asgjë tjetër në lutjen e tij! Kjo tregon pastërtinë shpirtërore dhe sedrën profetike të tij. Jusufi<sup>as</sup> ishte i dashuruar me Zotin, dhe shikimi i tij nuk mund të pëlqente asgjë tjetër përveç pëlqimit të Zotit. Jusufi<sup>as</sup> iu desh të qëndronte një kohë të gjatë në burg, periudhë e cila, në librat e tjerë përmendet të ishte rreth 12 vite. Por gjatë gjithë kësaj periudhe, ai nuk shfaqti ndonjë ankesë drejtuar qoftë mbretit, qoftë Zotit, madje u tregua tërësisht i kënaqur me vullnetin e Zotit. Thuhet se gjatë kësaj kohe, edhe gruaja në fjalë ia kishte shtuar dënimet, vetëm që ai ta pranonte propozimin e saj. Por i vërteti nuk e lëshoi vërtetësinë e tij. Zoti e cilësoi “të vërtetë”, dhe një ndër pozitat e të vërtetit është që asnjë fatkeqësi, asnjë mundim dhe asnjë poshtërim i kësaj bote nuk e detyron dot t’i shkelë kufijtë e caktuar nga Zoti. Madje, sa më shumë që i shtohen mundimet, aq më shumë ai përforcohet në vërtetësinë e tij dhe fiton kënaqësi.

shtrydhur lëngun për të bërë verë.”  
Dhe tjetri i tha: “Unë e shoh veten duke mbartur bukë në kokë, të cilën e hanë zogjtë. Na trego interpretimin e kësaj; ty të shohim që je nga mirëbërësit.”

38. Ai u tha: “Përpara se t’ju vijë ushqimi që do ta hani, unë do t’jua kem treguar interpretimin e kësaj. Kjo është nga ajo që më ka mësuar Zoti im. Sigurisht, e kam braktisur udhën e njerëzve që nuk besojnë në Allah dhe që mohojnë *ahiretin*.”

39. Kam ndjekur fenë e baballarëve të mi, Ibrahimit, Is’hakut dhe Jakubit. Nuk na takonte t’i atribuonim qoftë ndonjë ortak të vetëm Allahut. Kjo ishte nga bekimi i Allahut mbi ne dhe mbi njerëzit, por shumica e njerëzve nuk falënderojnë.

40. O shokët e mi të burgut! Më mirë janë zota të ndryshëm, apo Një, i Plotfuqishmi?!

41. Duke e lënë Atë, ju adhuroni vetëm ca emra që i keni quajtur vetë ju dhe etërit tuaj, për të cilët Allahu nuk ka zbritur ndonjë argument. Vendimi i takon vetëm Allahut. Ai urdhëroi të mos adhuroni askënd tjetër, por vetëm Atë. Kjo është feja e qëndrueshme, por shumica e njerëzve nuk dinë.

وَقَالَ الْآخَرُ إِنِّي أَرِنِي أَحْمِلُ فَوْقَ رَأْسِي خُبْرًا تَأْكُلُ الطَّيْرُ مِنْهُ نَبِّئْنَا بِتَأْوِيلِهِ ۚ إِنَّا نَرَاكَ مِنَ الْمُحْسِنِينَ ﴿٣٧﴾

قَالَ لَا يَأْتِيكُمَا طَعَامٌ تُرْزَقِينَ إِلَّا نَبَأْتُكُمَا بِتَأْوِيلِهِ قَبْلَ أَنْ يَأْتِيَكُمَا ۚ ذَلِكُمَا مِمَّا عَلَّمَنِي رَبِّي ۗ إِنِّي تَرَكْتُ مِلَّةَ قَوْمٍ لَا يُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَهُمْ بِالْآخِرَةِ هُمْ كَافِرُونَ ﴿٣٨﴾

وَاتَّبَعْتُ مِلَّةَ آبَائِي إِبْرَاهِيمَ وَإِسْحَاقَ وَيَعْقُوبَ ۗ مَا كَانَ لَنَا أَنْ نُشْرِكَ بِاللَّهِ مِنْ شَيْءٍ ۗ ذَلِكُمْ مِنْ فَضْلِ اللَّهِ عَلَيْنَا وَعَلَى النَّاسِ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَشْكُرُونَ ﴿٣٩﴾

يَصَاحِبِي السَّجْنِ ۚ أَرَبَابٌ مُتَفَرِّقُونَ خَيْرٌ أَمْ اللَّهُ الْوَاحِدُ الْقَهَّارُ ﴿٤٠﴾

مَا تَعْبُدُونَ مِنْ دُونِهِ إِلَّا أَسْمَاءُ سَمِيئُوهَا أَنْتُمْ وَآبَاؤُكُمْ مَا أَنْزَلَ اللَّهُ بِهَا مِنْ سُلْطَانٍ ۗ إِنْ أَحْكَمُ إِلَّا لِلَّهِ ۗ أَمَرَ إِلَّا تَعْبُدُوا إِلَّا إِيَّاهُ ۗ ذَلِكِ الدِّينُ الْقِيمُ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٤١﴾

42. O shokët e mi të burgut! Për sa i përket njërit prej jush, ai do t'i japë për të pirë verë padronit të tij, kurse tjetri, do të kryqëzohet dhe zogjtë do të ushqehen nga koka e tij. U krye çështja për të cilën ju më pyesnit.”

43. Prej të dyve, atij për të cilin (Jusufi) mendoi se do të shpëtonte, i tha: “Më përmend pranë padronit tënd”. Por djalli e bëri të harronte t'ia përmendte padronit të tij. Kështu për disa vjet (Jusufi) mbeti në burg.

44. Mbreti tha: “Unë shoh shtatë lopë të majme që hanë shtatë të tjera të dobëta, po ashtu, shtatë kallinj të gjelbër kurse të tjerët të thatë. O kryetarë! Më shpjegoni ëndrrën time, nëse dini të shpjegoni ëndrrat.”

45. Ata thanë: “Janë ëndrra të ngatërruara dhe ne nuk dimë shpjegimin e ëndrrave të tilla.”

46. Dhe ai që ishte një prej dyve (të burgut dhe) që shpëtoi, pas një kohe të gjatë e kujtoi Jusufin: “Unë do t'ju tregoj shpjegimin e kësaj (ëndrre), ndaj, më dërgoni (te Jusufi).

47. Jusuf, o i vërtetë! Na shpjego (ëndrrën) ku shtatë lopë të majme hanë shtatë të tjera të dobëta dhe shtatë kallinj të gjelbër dhe të tjerët të thatë! Që (kur) të kthehem tek njerëzit, ndoshta do ta kuptojnë (interpretimin e saj).”

يَصَاحِبِي السَّجْنِ أَمَا أَحَدٌ كَمَا فَيَسْقَى رَبَّهُ  
حَمْرًا<sup>٤٢</sup> وَأَمَّا الْآخَرُ فَيُصَلَّبُ فَتَأْكُلُ الطَّيْرُ  
مِنْ رَأْسِهِ<sup>٤٣</sup> فَضَى الْأَمْرُ الَّذِي فِيهِ  
تَسْتَفْتَيْنِ<sup>٤٤</sup>

وَقَالَ لِلَّذِي ظَنَّ أَنَّهُ نَاجٍ مِّنْهُمَا اذْكُرْنِي  
عِنْدَ رَبِّكَ<sup>٤٥</sup> فَأَنسَهُ الشَّيْطَانُ ذِكْرَ رَبِّهِ  
فَلَبِثَ فِي السَّجْنِ بِضْعَ سِنِينَ<sup>٤٦</sup>

وَقَالَ الْمَلِكُ إِنِّي أَرَى سَبْعَ بَقَرَاتٍ سِمَانٍ  
يَأْكُلْنَ سَبْعَ عِجَافٍ<sup>٤٧</sup> وَسَبْعَ سُنبُلَاتٍ خُضْرٍ  
وَأُخْرَ يُبَسِّتُ<sup>٤٨</sup> يَأَيُّهَا الْمَلَأَ أَفْتُونِي فِي  
رُءْيَايَ إِنْ كُنْتُمْ لِلرُّءْيَا تَعْبُرُونَ<sup>٤٩</sup>

قَالُوا أَضْغَاثُ أَحْلَامٍ<sup>٥٠</sup> وَمَا نَحْنُ بِتَأْوِيلِ  
الْأَحْلَامِ بِعِلْمَيْنِ<sup>٥١</sup>

وَقَالَ الَّذِي نَجَا مِنْهُمَا وَادَّكَرَ بَعْدَ أُمَّةٍ أَنَا  
أُنَبِّئُكُمْ بِتَأْوِيلِهِ فَأَرْسِلُونِ<sup>٥٢</sup>

يُوسُفُ أَيُّهَا الصِّدِّيقُ أَفْتِنَا فِي سَبْعِ بَقَرَاتٍ  
سِمَانٍ يَأْكُلْنَ سَبْعَ عِجَافٍ<sup>٥٣</sup> وَسَبْعِ سُنبُلَاتٍ  
خُضْرٍ وَأُخْرَ يُبَسِّتُ<sup>٥٤</sup> لَعَلِّي أَرْجِعَ إِلَى  
النَّاسِ لَعَلَّهُمْ يَعْلَمُونَ<sup>٥٥</sup>



48. Ai tha: “Do të mbillni shtatë vjet me radhë. Atëherë ato që do t’i korrni, lërinë në kallinj të tyre, përveçse një pjesë të vogël që do të hani.

49. Dhe pas kësaj do të vijnë shtatë (vite) të vështira, që do të hanë nga ato që keni mbajtur në rezerva për to, përveçse një pjesë të vogël që do ta ruani (për mbjellje).

50. Dhe pas kësaj do të vijë një vit në të cilin njerëzit do të kenë shi dhe do të shtrydhin (nga bollëku i frutave).”

51. Mbreti tha: “Ma sillni atë!” Dhe kur i erdhi lajmëtari, (Jusufi i) tha: “Kthehu te padroni yt dhe pyete se si është çështja e atyre grave që prenë duart e veta. Zoti im e di shumë mirë kurthin e tyre.”

52. (Mbreti) i pyeti (gratë): “Çfarë ju ndodhi kur donit ta joshnit Jusufin kundër dëshirës së tij?” Ato thanë: “I Shenjtë është Allahu! Nuk dimë për ndonjë të keqe tek ai”. Gruaja e ministrit tha: “Tashmë u zbulua e vërteta! Unë (tentova) ta joshja kundër dëshirës së tij dhe ai, pa dyshim, ka qenë ndër të vërtetët”.

53. (Jusufi tha:) “Kjo ndodhi që ta dijë (ministri) që unë nuk e kam tradhtuar në mungesë të tij dhe që Allahu nuk e vë në udhë kurthin e tradhtarëve.

قَالَ تَزْرَعُونَ سَبْعَ سِنِينَ دَابَّاهُ فَمَا  
حَصَدْتُمْ فَذَرُوهُ فِي سُنْبُلَةٍ إِلَّا قَلِيلًا  
مِّمَّا تَأْكُمُونَ ﴿٤٨﴾

ثُمَّ يَأْتِي مِنْ بَعْدِ ذَلِكَ سَبْعٌ شِدَادٌ يَأْكُلْنَ  
مَا قَدَّمْتُمْ لَهُنَّ إِلَّا قَلِيلًا مِّمَّا خُصُّونَ ﴿٤٩﴾

ثُمَّ يَأْتِي مِنْ بَعْدِ ذَلِكَ عَامٌ فِيهِ يُعَاتُّ  
بِئْسَ النَّاسُ وَفِيهِ يُعْصِرُونَ ﴿٥٠﴾

وَقَالَ الْمَلِكُ إِنِّي أرى فِيهَا فَلَ مَا جَاءَهُ  
الرَّسُولُ قَالَ ارْجِعْ إِلَى رَبِّكَ فَسَلَّهُ مَا  
بِالْسُّوَةِ الَّتِي قَطَعْنَ أَيْدِيَهُنَّ إِنَّ رَبِّي  
بِكَيْدِهِنَّ عَلِيمٌ ﴿٥١﴾

قَالَ مَا خَطْبُكُمْ إِذْ رَاوَدْتُنَّ يُوسُفَ عَنْ  
نَفْسِهِ قُلْنَ حَاشَ لِلَّهِ مَا عَلِمْنَا عَلَيْهِ  
مِنْ سُوءٍ قَالَتِ امْرَأَتُ الْعَزِيزِ إِنَّ  
حَصْحَصَ الْحَقُّ أَنَا رَاوَدْتُهُ عَنْ نَفْسِهِ  
وَإِنَّهُ لَمِنَ الصَّادِقِينَ ﴿٥٢﴾

ذَلِكَ لِيَعْلَمَ أَنِّي لَمْ أَخُنْهُ بِالْغَيْبِ وَأَنَّ  
اللَّهَ لَا يَهْدِي كَيْدَ الْخَائِبِينَ ﴿٥٣﴾

54. Dhe unë nuk e shfajësoj veten time. Njëmend, vetvetja nxit shumë për të keqen, përveç asaj që mëshiron Zoti im. Sigurisht, Zoti im është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.<sup>6</sup>

55. Mbreti tha: “Silleni tek unë, do ta zgjedh për veten time.” E kur ai bisedoi me të, tha: “Nga sot, ti je i fuqishëm, i besueshëm pranë nesh.”

56. (Jusufi) tha: “Më cakto mbi thesaret e vendit. Sigurisht, jam ruajtës, i ditur.”

57. Dhe kështu Ne e forcuam Jusufin në vend. Ai qëndronte në të ku të donte. Ne i sjellim mëshirën Tonë kujt të duam dhe nuk ua humbim shpërblimin mirëbërësve.

58. Shpërblimi i *ahiretit* është më i mirë për ata që besuan dhe patën druajtje (ndaj Zotit).

59. Vëllezërit e Jusufit mbërritën dhe erdhën pranë tij. Ai i njohu, kurse ata nuk e njihnin.

وَمَا أَرْبِي نَفْسِي ۚ إِنَّ النَّفْسَ لَأَمَّارَةٌ  
بِالسُّوءِ ۗ إِلَّا مَا رَحِمَ رَبِّي ۗ إِنَّ رَبِّي غَفُورٌ  
رَّحِيمٌ ﴿٦٤﴾

وَقَالَ الْمَلِكُ ائْتُونِي بِهِ ۗ أَسْتَخَصُّهُ  
لِنَفْسِي ۚ فَلَمَّا كَلَّمَهُ قَالَ إِنَّكَ الْيَوْمَ  
لَدَيْنَا مَكِينٌ أَمِينٌ ﴿٦٥﴾

قَالَ اجْعَلْنِي عَلَى خَزَائِنِ الْأَرْضِ ۚ إِنِّي  
حَفِيظٌ عَلِيمٌ ﴿٦٦﴾

وَكَذَلِكَ مَكَّنَّا لِيُوسُفَ فِي الْأَرْضِ ۚ يَتَّبِعُونَ  
مِنْهَا حَيْثُ يَشَاءُ ۗ نُصِيبُ بِرَحْمَتِنَا  
مَنْ نَشَاءُ ۗ وَلَا نُضِيعُ أَجْرَ الْمُحْسِنِينَ ﴿٦٧﴾

وَلَأَجْرُ الْآخِرَةِ خَيْرٌ لِلَّذِينَ آمَنُوا وَكَانُوا  
يَتَّقُونَ ﴿٦٨﴾

وَجَاءَ إِخْوَةُ يُوسُفَ فَدَخَلُوا عَلَيْهِ  
فَعَرَفَهُمْ وَهُمْ لَهُ مُنْكَرُونَ ﴿٦٩﴾

6. Sipas Kuranit të Shenjtë, shpirti njerëzor kalon në tri gjendje: (1) shpirti që urdhëron për të keqen (*nefsun emmāreh*) (12:54), (2) shpirt qortues (*nefsun levvāme*) (75:3) dhe (3) shpirti i qetësuar (*nefsun mutmeinne*) (89:28-31). Në gjendjen e parë, njeriu është i prangosur në ndikimin e djallit dhe i ndjek vetëm instinktet, porsì shtazët. Në gjendjen e dytë, ai pendohet për gabimet e tij, anon nga Zoti, por dualizmi brenda tij nuk gjen qetësi; ai herë anon nga shejtani, e herë nga Rrahmani (i Gjithëmëshirshmi). Kurse në gjendjen e tretë, ai hyn në grupin e adhuresve të përsosur të të Gjithëmëshirshmit. Është e vërtetë që në moshën e rinisë, njeriu zakonisht tundohet dhe shumëkush nuk arrin të dalë nga gjendja e parë e shpirtit, por për fatbardhët, po kjo moshë është koha për punë, andaj, Zoti na jep shembullin e Jusufit<sup>as</sup>. Fjalët e këtij ajeti tregojnë se njeriut nuk i mjafton vetëm përpjekja e tij për të shpëtuar nga tundimet e kësaj gjendjeje, por i duhet edhe t'i lutet shumë Zotit. Spiritualizmi i vërtetë nuk arrihet vetëm me përpjekjet personale, por dhurohet prej Zotit në saje të mëshirës dhe bekimit të Tij.

60. Kur i bëri gati (të ktheheshin) me furnizimet e tyre, u tha: “Më sillni vëllain që keni nga babai juaj. A nuk shikoni se unë jap të plotë masën dhe jam mikpritës shumë i mirë?!”

61. Po nuk ma sollët atë, tek unë, nuk do ta merrni masën (të plotësuar) dhe as mos m’u afroni.”

62. Ata thanë: “Ne do të tentojmë ta joshim babanë e tij për të dhe do ta bëjmë patjetër.”

63. Ai u tha shërbyesve të vet: “Futuni paratë në thesin e tyre, që kur të shkojnë te familja e tyre, ta dinë (për nder dhe) ndoshta të kthehen (sërish).”

64. E kur ata u kthyen te babai i tyre, thanë: “O babai ynë! Na u mohua furnizimi, andaj, dërgo vëllain tonë me ne, që ta sjellim furnizimin dhe ne sigurisht që jemi ruajtës të tij.”

65. Ai tha: “A t’ju besoj për të, ndryshe nga ajo siç ju kam besuar për vëllain e tij më parë?! Allahu është Ruajtësi më i mirë dhe Ai është më i mëshirshmi nga të gjithë mëshiruesit.”

66. Dhe kur e hapën ngarkesën, gjetën paratë e tyre që ua kishin kthyer. Thanë: “O babai ynë! Çfarë duam (më tepër)! Ja, na i paskan kthyer edhe paratë tona! Ne do të sjellim furnizimin për familjen tonë, do ta ruajmë vëllain tonë dhe do ta

وَلَمَّا جَهَّزَهُمْ بِجَهَّازِهِمْ قَالِ ائْتُونِي بِاِخْتِ لَكُمْ مِّنْ اٰيٰتِكُمْ ؕ اِلَّا تَرَوْنَ اَنِيْ اَوْفِي الْكَيْلِ وَاَنَا حَيْرٌ اَلْمُنْزِلِيْنَ ۝۶۰

فَاِنْ لَّمْ تَاْتُوْنِيْ بِهٖ فَلَا كَيْلَ لَكُمْ عِنْدِيْ وَلَا تَقْرَبُوْنِ ۝۶۱

قَالُوْا سُرُوْدٌ عِنْدَ اٰبَاءِ وَاِنَّا لَفَعْلُوْنَ ۝۶۲

وَقَالَ نَفْسِيْهِ اجْعَلُوْا بِضَاعَتَهُمْ فِيْ رِحَالِهِمْ لَعَلَّهُمْ يَعْرِفُوْنَهَا اِذَا اَنْقَلَبُوْا اِلَى اٰهْلِهِمْ لَعَلَّهُمْ يَرْجِعُوْنَ ۝۶۳

فَلَمَّا رَجَعُوْا اِلَى اٰبِيْهِمْ قَالُوْا يَا اٰبَانَا مَنِيْعٌ مِّنَّا اَنْ كَيْلَ فَاَرْسَلْ مَعَنَا اٰخَانَ نَكْتُلْ وَاِنَّا لَهٗ لَحٰفِظُوْنَ ۝۶۴

قَالَ هَلْ اٰمَنْتُمْ عَلَيْهِ اِلَّا كَمَا اٰمَنْتُمْ عَلٰى اٰخِيْهِ مِنْ قَبْلُ ؕ قَالُوْا حٰيْرٌ حٰفِظًا ؕ وَهُوَ اَرْحَمُ الرَّحِيْمِيْنَ ۝۶۵

وَلَمَّا فَتَحُوْا مَتَاعَهُمْ وَجَدُوْا بِضَاعَتَهُمْ رَدَّتْ اِلَيْهِمْ ۝۶۶ قَالُوْا يَا اٰبَانَا مَا نَبْعِيْ هٰذِهِ بِضَاعَتُنَا رَدَّتْ اِلَيْنَا ؕ وَنَحِيْرٌ اٰهْلَنَا وَحَفِظْ اٰخَانَ وَزَرَدًا كَيْلَ بَعِيْرٍ ۝۶۷

gjejmë ngarkesën e një deveje shtesë. Kjo qenka ngarkesë e lirë!”

67. Ai tha: “Kurrresi nuk do ta dërgoj atë me ju, gjersa të më jepni premtim të fortë për Allahun, që ju do të ma sillni patjetër, përveçse nëse ju zë prita.” Kur ata ia dhanë premtimin, ai tha: “Allahu është Mbikëqyrës për atë që themi.”

68. Dhe tha: “O bijtë e mi! Mos hyni nga një portë e vetme, por hyni nga porta të ndryshme dhe unë nuk mund t’ju shpëtoj aspak (nga caktimi) prej Allahut; urdhri është vetëm i Allahut; Atij iu mbështeta dhe Atij le t’i mbështeten ata që kërkojnë mbështetje.”

69. Atëherë ata hynë prej andej nga i kishte urdhëruar babai i tyre. Ai (me këtë) nuk mund t’i lironte dot aspak (nga caktimi) prej Allahut, por ishte një dëshirë në zemrën e Jakubit, që ai e kreu. Ai zotëronte dije për shkak se Ne i kishim dhënë dije, por shumica e njerëzve nuk e dinë.

70. Kur ata u paraqitën te Jusufi, ai e afroi vëllain e tij (dhe) i tha: “Unë jam vëllai yt, ndaj mos u brengos nga ajo që ata kanë bërë!”

71. Kur i bëri gati (të ktheheshin) me furnizimet e tyre, ai vuri (nga padija) kupën e ujit në ngarkesën e vëllait të tij. Pastaj, një njoftues njoftoi: “O karvan! Jeni vjedhës!”

ذٰلِكَ كَيْلٌ يَّسِيرٌ ﴿١٦﴾

قَالَ لَنْ أَرْسِلَهُ مَعَكُمْ حَتَّى تُؤْتُوانَا مَوْثِقًا مِّنَ اللَّهِ لَتَأْتُنَّنِي بِهِ إِلَّا أَنْ يُحَاطَ بِكُمْ ۚ فَلَمَّا آتَوْهُ مَوْثِقَهُمْ قَالَ اللَّهُ عَلَىٰ مَا نَقُولُ وَكِيلٌ ﴿١٧﴾

وَقَالَ يَبْنَئِي لَأَ تَدْخُلُوا مِن بَابٍ وَاحِدٍ وَادْخُلُوا مِنْ أَبْوَابٍ مُّتَفَرِّقَةٍ وَمَا أُغْنِي عَنْكُمْ مِنَ اللَّهِ مِنْ شَيْءٍ ۗ إِنِ الْحُكْمُ إِلَّا لِلَّهِ ۗ عَلَيْهِ تَوَكَّلْتُ وَعَلَيْهِ فَلْيَتَوَكَّلِ الْمُتَوَكِّلُونَ ﴿١٨﴾

وَلَمَّا دَخَلُوا مِنْ حَيْثُ أَمَرَهُمْ أَبُوهُمْ ۗ مَا كَانَ يُغْنِي عَنْهُمْ مِنَ اللَّهِ مِنْ شَيْءٍ إِلَّا حَاجَةٌ فِي نَفْسٍ يَعْقُوبَ قَضَاهَا وَإِنَّهُ لَذُو عِلْمٍ لِّمَا عَلَّمْنَاهُ وَلَٰكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ ﴿١٩﴾

وَلَمَّا دَخَلُوا عَلَىٰ يُوسُفَ أَوَىٰ إِلَيْهِ أَخَاهُ قَالَ إِنِّي أَنَا أَخُوكَ فَلَا تَبْتَئِسْ بِمَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿٢٠﴾

فَلَمَّا جَهَّزَهُمْ بِجَهَازِهِمْ جَعَلَ السِّقَايَةَ فِي رَحْلِ أَخِيهِ ثُمَّ أَذَّنَ مُؤَذِّنٌ أَيَّتُهَا الْعِيرُ إِنَّكُمْ لَسِرْقُونَ ﴿٢١﴾

72. Ata dolën përpara tyre dhe thanë:  
“Çfarë është ajo që ju mungon?”

قَالُوا وَأَقْبَلُوا عَلَيْهِمْ مَاذَا تَفْقِدُونَ ﴿٧٢﴾

73. Thanë: “Na mungon masa e mbretit dhe kushdo që do ta sjellë, do t’i jepet ngarkesa e një deveje dhe unë jam garant për këtë.”<sup>7</sup>

قَالُوا نَفْقِدُ صُوَاعَ الْمَلِكِ وَلِمَنْ جَاءَ بِهِ  
حِمْلُ بَعِيرٍ وَأَنَا بِهِ زَعِيمٌ ﴿٧٣﴾

74. (Vëllezërit) thanë: “Për Allahun! Ju e dini mirë që ne nuk kemi ardhur për të bërë çrregullime në vend dhe as nuk jemi vjedhës.”

قَالُوا تَاللَّهِ لَقَدْ عَلِمْتُمْ مَا جِئْنَا لِنُفْسِدَ  
فِي الْأَرْضِ وَمَا كُنَّا سَارِقِينَ ﴿٧٤﴾

75. Ata pyetën: “Çfarë do të jetë dënimi i kësaj, nëse dilni gënjeshtarë?”

قَالُوا فَمَا جَزَاءُوهُ إِنْ كُنْتُمْ كَذِبِينَ ﴿٧٥﴾

76. Thanë: “Dënimi i saj le të jetë ai (vetë), në ngarkesën e të cilit gjendet ajo. Ne kështu i dënojmë keqbërësit.”

قَالُوا جَزَاءُوهُ مَنْ وُجِدَ فِي رَحْلِهِ فَهُوَ  
جَزَاءُوهُ ۖ كَذَلِكَ نَجْزِي الظَّالِمِينَ ﴿٧٦﴾

77. Atëherë (njoftuesi) filloi (kontrollin) me thasët e tyre, para thesit të vëllait të tij<sup>8</sup> dhe më pas e nxori nga thesi i vëllait të tij. Në këtë mënyrë, Ne planifikuam për Jusufin. Ai nuk kishte mundësi ta merrte vëllain e tij në sundimin e mbretit, përveçse nëse donte Allahu. Ne i ngremë pozita kujt të duam. Mbi çdo zotërues të dijës, është një i Gjithëdijshëm.

فَبَدَأَ بِأَوْعِيَّتِهِمْ قَبْلَ وِعَاءِ آخِيهِ  
ثُمَّ اسْتَخْرَجَهَا مِنْ وِعَاءِ آخِيهِ ۖ كَذَلِكَ  
كِدْنَا يُوسُفَ ۖ مَا كَانَ لِيَأْخُذَ آخَاهُ فِي  
دِينِ الْمَلِكِ إِلَّا أَنْ يَشَاءَ اللَّهُ ۖ نَرْفَعُ  
دَرَجَاتٍ مَن نَّشَاءُ ۖ وَفَوْقَ كُلِّ ذِي  
عِلْمٍ عَلِيمٌ ﴿٧٧﴾

78. Ata thanë: “Nëse ai ka vjedhur, ka vjedhur më parë edhe një vëlla i tij.”

قَالُوا إِنْ يَسْرِقْ فَقَدْ سَرَقَ أَخٌ لَهُ مِنْ  
قَبْلُ ۚ فَأَسْرَهَا يُوسُفُ فِي نَفْسِهِ وَلَمْ

7. Masa e mbretit nuk ishte vënë me vetëdije në thesin e vëllait të Jusufit<sup>as</sup>, por gabimisht. Përndryshe, Zoti i Madhërishëm nuk do të thoshte: “Ne kështu planifikuam për Jusufin”. Ky plan, po të ishte nga Jusufi, Zoti nuk do ta merrte përsipër autorësinë.

8. Pra, të Jusufit.

Atëherë Jusufi u përmbajt në vetvete dhe nuk ua shfaqti (gënjeshtrën). Tha (me vete): “Jeni në gjendjen më të ligë dhe Allahu e di më së miri atë që thoni.”

79. Ata thanë: “O ministër! Ai ka një baba shumë të moshuar, andaj, mbaj ndonjërin prej nesh në vend të tij. Sigurisht, ne ty të shohim nga mirëbërësit.”

80. Ai tha: “Allahu na ruajttë të mbajmë njeri tjetër përveç atij, të cilit i kemi gjetur mallin tonë. Do të ishim vërtetë të padrejtë!”

81. Kur ata mbetën të pashpresë, u mënjanuan për t’u këshilluar. I madhi i tyre tha: “A nuk dini se babai juaj ju ka marrë premtim të fortë për Allahun dhe se çfarë shkeljesh keni bërë më përpara në lidhje me Jusufin?! Unë nuk do ta lëshoj këtë vend, gjersa të më lejojë babai im ose të vendosë Allahu për mua, dhe Ai është më i miri për të vendosur.

82. Kthehuni te babai juaj dhe thojini: ‘O babai ynë! I biri yt vërtet ka vjedhur dhe ne nuk dëshmojmë asgjë tjetër përveç asaj që mësuam dhe ne nuk i jemi rojë së padukshmes.

83. Pyeti (banorët e) fshatit në të cilin ishim, dhe karvanin me të cilin erdhëm. Sigurisht, ne themi të vërtetën.”

يُبْدِيهَا لَهُمْ ۖ قَالَ أَنْتُمْ شَرٌّ مَكَانًا  
وَاللَّهُ أَعْلَمُ بِمَا تَصِفُونَ ﴿٧٩﴾

قَالُوا يَا أَيُّهَا الْعَزِيزُ إِنَّ لَهُ أَبًا شَيْخًا  
كَبِيرًا فَخُذْ أَحَدَنَا مَكَانَهُ ۚ إِنَّا نَرَاكَ  
مِنَ الْمُحْسِنِينَ ﴿٨٠﴾

قَالَ مَعَاذَ اللَّهِ أَنْ نَأْخُذَ إِلَّا مَنْ وَجَدْنَا  
بِهِ مَتَاعَنَا عِنْدَهُ ۚ إِنَّا إِذَا أَطْلَمُونَ ﴿٨١﴾

فَلَمَّا اسْتَيْسَسُوا مِنْهُ خَاصُوا نَجِيًّا ۖ  
قَالَ كَبِيرُهُمْ أَلَمْ تَعْلَمُوا أَنَّ أَبَاكُمْ  
قَدْ أَخَذَ عَلَيْكُمْ مَوْثِقًا مِنَ اللَّهِ وَمِنْ  
قَبْلُ مَا فَرَّطْتُمْ فِي يُوسُفَ ۚ فَلَنْ  
أَبْرَحَ الْأَرْضَ حَتَّىٰ يَأْذَنَ لِي أَبِي  
أَوْ يَحْكَمَ اللَّهُ لِي ۚ وَهُوَ خَيْرُ الْحَاكِمِينَ ﴿٨٢﴾

إِرْجِعُوا إِلَىٰ آبَائِكُمْ فَقُولُوا يَا أَبَانَا إِنَّ  
ابْنَكَ سَرَقَ ۚ وَمَا شَهِدْنَا إِلَّا بِمَا عَلَّمْنَا  
وَمَا كُنَّا لِلْغَيْبِ حَافِظِينَ ﴿٨٣﴾

وَسَلَّ الْقَرْيَةَ الَّتِي كُنَّا فِيهَا وَالْعَيْرَ  
الَّتِي أَقْبَلْنَا فِيهَا ۚ وَإِنَّا لَصَادِقُونَ ﴿٨٤﴾

84. (Jakubi) tha: “Përkundrazi, vetja juaj ju ka bërë të lehtë një çështje (të rëndë). Andaj, (s’më mbetet veçse) durim i denjë! Mundet që Allahu të m’i sjellë që të gjithë. Sigurisht, Ai është i Gjithëdijshmi, i Urti.”

85. Dhe ai u mënjanua prej tyre dhe tha: “Sa keq për Jusufin!” Atij iu mbushën sytë<sup>9</sup> nga brenga, por ai përmbahej.

86. Ata thanë: “Për Allahun! Ti do ta kujtosh vetëm Jusufin aq saqë do të lodhesh (nga brenga) ose do të shkatërrohesh.”

87. Ai tha: “Unë e qaj hallin dhe brengën vetëm tek Allahu dhe e di prej Allahut atë që ju nuk e dini.

88. O bijtë e mi! Shkoni dhe kërkoni Jusufin dhe vëllain e tij dhe mos u dëshpëroni nga mëshira e Allahut. Sigurisht, askush nuk dëshpërohet nga mëshira e Allahut, përveç njerëzve mohues.”

89. Dhe kur ata erdhën pranë tij (pranë Jusufit), thanë: “O ministër! Na ka zënë vështirësia ne dhe familjen tonë dhe kemi ardhur me një pasuri të vogël, andaj jepna furnizimin përsëri dhe falna lëmoshë, sigurisht, Allahu i

قَالَ بَلْ سَوَّلَتْ لَكُمْ أَنْفُسُكُمْ أَمْرًا  
فَصَبْرٌ جَمِيلٌ عَسَى اللَّهُ أَنْ يَأْتِيَنِي  
بِهِمْ جَمِيعًا إِنَّهُ هُوَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ ﴿٨٤﴾

وَتَوَلَّى عَنْهُمْ وَقَالَ يَا سَفَى عَلَى يُونُسَ  
وَابْيَضَّتْ عَيْنُهُ مِنَ الْحَزَنِ فَهُوَ  
كَبِيمٌ ﴿٨٥﴾

قَالُوا تَاللَّهِ تَقْتُؤَا تَذَكَّرُ يُونُسَ حَتَّى  
تَكُونَ حَرَضًا أَوْ تَكُونَ مِنَ الْهَالِكِينَ ﴿٨٦﴾

قَالَ إِنَّمَا أَشْكُوا بَثِّي وَحُزْنِي إِلَى اللَّهِ  
وَأَعْلَمُ مِنَ اللَّهِ مَا لَا تَعْلَمُونَ ﴿٨٧﴾

يَبْنِي أَذْهَبُوا فَتَحَسَّسُوا مِنْ يُونُسَ  
وَآخِيهِ وَلَا تَأْيِسُوا مِنْ رَوْحِ اللَّهِ إِنَّهُ  
لَا يَأْيِسُ مِنْ رَوْحِ اللَّهِ إِلَّا الْكُفْرُونَ ﴿٨٨﴾

فَلَمَّا دَخَلُوا عَلَيْهِ قَالُوا يَا أَيُّهَا الْعَزِيزُ  
مَسْنَا وَاهْلَنَا الضُّرُّ وَجِئْنَا بِبِضَاعَةٍ  
مُرْجَبَةٍ فَأَوْفِ لَنَا الْكَيْلَ وَتَصَدَّقْ

9. “*veb-jeddat ajnahu*” fjalë për fjalë përkthehen “*iu zbardhën sytë*”, por nuk do të thotë se ai u verbua, por do të thotë, atij iu mbushën sytë me lot. *Hazret Imam Razi*<sup>ra</sup> shkruan se “*iu zbardhën sytë*” nënkupton brengosjen e thellë (Raziu, kom. i ajetit 12:84). Edhe fjala “*kedhim*” (“e përmban brengën”), e mbështet këtë kuptim, sepse ajo rrjedh nga “*kedhm*” që do të thotë të durosh brengën. Pikërisht për këtë arsye, *Hazret Jakubit*<sup>as</sup> iu mbushën sytë me lot.

shpërblen ata që japin lëmoshë.”

عَلَيْنَا إِنَّ اللَّهَ يَجْزِي الْمُتَصَدِّقِينَ ﴿٩٩﴾

90. Ai tha: “A e dini se çfarë bëtë me Jusufin dhe vëllain e tij, kur ishit të paditur?!”

قَالَ هَلْ عَلِمْتُمْ مَا فَعَلْتُمْ بِيُوسُفَ  
وَآخِيهِ إِذْ أَنْتُمْ جَاهِلُونَ ﴿١٠٠﴾

91. Thanë: “A ti je Jusufi?” Ai tha: “Po, unë jam Jusufi dhe ky është vëllai im. Allahu na ka begatuar. Kushdo që përvetëson druajtje (ndaj Allahut) dhe duron, Allahu kurrë nuk ua humb shpërblimin mirëbërësve.”

قَالُوا ءِ إِنَّكَ لَأَنْتَ يُوسُفُ قَالَ أَنَا  
يُوسُفُ وَهَذَا أَخِي قَدْ مَنَّ اللَّهُ عَلَيْنَا  
إِنَّهُ مَنْ يَتَّقِ وَيَصْبِرْ فَإِنَّ اللَّهَ لَا يُضِيعُ  
أَجْرَ الْمُحْسِنِينَ ﴿١٠١﴾

92. Ata thanë: “Për Allahun! Allahu të ka dhënë epërsi mbi ne dhe sigurisht, ne kemi qenë fajtorë.”

قَالُوا تَاللَّهِ لَقَدْ أَثَرْنَا اللَّهَ عَلَيْنَا وَإِنْ  
كُنَّا لَخَطِيئِينَ ﴿١٠٢﴾

93. Ai tha: “Sot nuk ka qortim për ju. Allahu do t’ju falë dhe Ai është më i mëshirshmi nga të gjithë mëshiruesit.

قَالَ لَا تَثْرِبَ عَلَيْكُمْ أَيُّومَ ط يَعْفِرُ اللَّهُ  
لَكُمْ وَهُوَ أَرْحَمَ الرَّحِيمِينَ ﴿١٠٣﴾

94. Merrni këtë këmishë timen dhe vëreni përpara babait tim, do t’i hapen sytë. Dhe (pastaj) më ejani me gjithë familje.”

إِذْهَبُوا بِقَمِيصِي هَذَا فَأَلْقُوهُ عَلَى وَجْهِ  
أَبِي يَأْتِ بِصِيرًا وَأَنْتَوِي بِأَهْلِكُمْ  
﴿١٠٤﴾ أَجْمَعِينَ ﴿١٠٤﴾

95. Ndërkohë që karvani u nis, babai i tyre tha: “Unë po ndiej erën e Jusufit, edhe pse ju do të më quani të çmendur.”<sup>10</sup>

وَلَمَّا فَصَلَتِ الْعِيرُ قَالَ أَبُوهُمْ إِنِّي  
لَأَجِدُ رِيحَ يُوسُفَ لَوْ لَا أَنْ تُفَنِّدُونِ ﴿١٠٥﴾

10. *Keshfi* (vizioni) është një përjetim shpirtëror. Njeriun e pushton një dremitje në atë mënyrë që ai është i vetëdijshëm për gjithçka dhe, edhe shqisat i punojnë. Në këto çaste Zoti i mundëson disa shqisa të reja për të parë pamjet e botës së të padukshmes. Këto shqisa i dhurohen në forma të ndryshme, herë i jepet shqisa e të parit, herë e të nuhaturit, herë ajo e të dëgjuarit etj.. Kështu *Hazret Jakubi*<sup>as</sup> tha – “Unë po ndiej erën e Jusufit, edhe pse ju do të më quani të çmendur.” Pra, ishin pikërisht shqisa të reja që Zoti në atë moment i kishte dhënë *Jakubit*<sup>as</sup> dhe ai arriti të mësonte se Jusufi ishte i gjallë dhe së shpejti do të takohej me të. Këtë erë nuk e nuhatën dot të tjerët që ishin të pranishëm aty, sepse atyre nuk u ishte dhënë ajo shqisë që i ishte dhënë *Jakubit*<sup>as</sup>. Për llojet e komunikimit me Zotin, lexoni 42:52.



96. (Familjarët) thanë: “Për Allahun!  
Ti je në gabimin tënd të vjetër.”

97. Dhe kur erdhi lajmëtari dhe e  
vuri (këmishën) përpara tij, atij iu  
hapën sytë. Tha: “A nuk ju thosha:  
Unë me të vërtetë di prej Allahut atë  
që ju nuk e dini.”

98. Ata thanë: “O babai ynë! Kërko  
(pranë Zotit) falje për mëkatet tona.  
Sigurisht ne kemi qenë fajtorë.”

99. Ai tha: “Unë patjetër do t’i kërkoj  
Zotit tim falje për ju. Pa dyshim, Ai  
është Falësi, Mëshirëbërësi.”

100. Dhe kur ata erdhën pranë  
Jusufit, ai u dha prindërve të tij një  
vend të afërt dhe tha: “Hyni me paqe  
në Egjipt, në dashtë Allahu.”

101. Ai i ngriti prindërit në fron dhe  
ata (të gjithë) ranë në sexhde për të.  
Ai tha: “O babai im! Ky është kuptimi  
i ëndrrës sime që kam paraparë. Zoti  
im e bëri që të ndodhte me të vërtetë.  
Ai më bëri mirësi kur më nxori nga  
burgu dhe ju solli nga shkretëtira,  
pas asaj që djalli kishte futur ndasi  
mes meje dhe mes vëllezërve të  
mi. Sigurisht, Zoti im është shumë  
Mirëbërës për atë që do; Ai është i  
Gjithëdijshmi, i Urti.

102. O Zoti im! Pa dyshim, Ti më  
dhe pushtetin dhe më dhe dijen për  
të kuptuar realitetin e çështjeve!  
O Krijuesi i qiejve dhe i tokës! Ti je

﴿١٦﴾ قَالُوا تَاللّٰهِ اِنَّكَ لَفِي ضَلٰلٍۭكَ الْقَدِيْمِ ﴿١٦﴾

فَلَمَّا اَنْ جَاءَ الْبَشِيْرُ اَنْفُسَهُ عَلٰى وَّجْهِهِ  
فَارْتَدَّ بَصِيْرًا ۗ قَالَ اَلَمْ اَقُلْ لَّكُمْ اِنِّي  
اَعْلَمُ مِنَ اللّٰهِ مَا لَا تَعْلَمُوْنَ ﴿١٧﴾

قَالُوا يَا اٰبَانَا اِسْتَغْفِرْ لَنَا ذُنُوْبَنَا اِنَّا كُنَّا  
خٰطِيْنَ ﴿١٨﴾

قَالَ سَوْفَ اَسْتَغْفِرُ لَكُمْ رَبِّيْ ۗ اِنَّهُ هُوَ  
الْغَفُوْرُ الرَّحِيْمُ ﴿١٩﴾

فَلَمَّا دَخَلُوْا عَلٰى يُوْسُفَ اٰوٰى اِلَيْهِ  
اَبُوْيهٖ وَقَالَ ادْخُلُوْا مِصْرَ اِنْ شَاءَ اللّٰهُ  
اٰمِيْنَ ﴿٢٠﴾

وَرَفَعَ اَبُوْيهٖ عَلٰى الْعَرْشِ وَخَرُّوْا لَهٗ  
سُجَّدًا ۗ وَقَالَ يَا بَتُّ هٰذَا تَاوِيْلُ رُّءْيَايَ  
مِنْ قَبْلُ ۗ قَدْ جَعَلَهَا رَبِّيْ حَقًّا ۗ وَقَدْ  
اَحْسَنَ بِيْ اِذْ اَخْرَجْتَنِيْ مِنَ السِّجْنِ  
وَجَاءَ بِكُمْ مِّنَ الْبَدْوِ مِنْۢ بَعْدِ اَنْ تَرَعَّ  
الشَّيْطٰنُ بَيْنِيْ وَبَيْنَ اٰخُوْتِيْ ۗ اِنَّ رَبِّيْ  
لَطِيْفٌ لِّمَآ يَشَآءُ ۗ اِنَّهُ هُوَ الْعَلِيْمُ  
الْحَكِيْمُ ﴿٢١﴾

رَبِّ قَدْ اٰتَيْتَنِيْ مِنَ الْمَلِكِ وَعَلَّمْتَنِيْ مِنْ  
تَاوِيْلِ الْاَحَادِيْثِ ۗ فَاطِرَ السَّمٰوٰتِ

Miku im në këtë botë dhe në tjetrën!  
Më jep vdekje kur të jem i nënshtruar  
dhe më bashko me të dëlirët.”

103. Këto janë lajmet e së padukshmes që Ne t'i shpallim ty. Ti nuk ishe pranë tyre kur ata ranë në ujdi për çështjen e tyre dhe kur intrigonin.

104. Shumica e njerëzve, sado që të dëshirosh, nuk do të besojnë.

105. Ti nuk u kërkon ndonjë shpërblim për këtë. Kjo është vetëm një këshillë për botët.

106. Sa shumë shenja ka në qiej e tokë, pranë të cilave ata kalojnë, por ata vetëm u shmangen.

107. Dhe shumica e tyre nuk besojnë në Allah, pa i sajuar ortakë (Atij).

108. Atëherë, a janë të sigurt se nuk do t'i mbulojë një dënim i Allahut ose t'u vijë Ora papritmas kur të jenë të pavetëdijshëm?!

109. Thuaj: “Kjo është rruga ime; thërras drejt Allahut; qëndrojmë mbi dije të sigurt unë dhe ai që më ndjek mua. I Shenjtë është Allahu dhe unë nuk jam nga idhujtarët.”

110. Edhe para teje u kemi dërguar banorëve të vendbanimeve vetëm burra, të cilëve u shpallnim.

وَالْأَرْضِ ۖ أَنْتَ وَرَبُّكَ فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ ۗ  
تَوَفَّنِي مُسْلِمًا وَأَلْحَقْنِي بِالصَّالِحِينَ ﴿١٠٣﴾

ذَلِكَ مِنْ أَنْبَاءِ الْغَيْبِ نُوحِيهِ إِلَيْكَ ۗ وَمَا  
كُنْتَ لَدَيْهِمْ إِذْ أَجْمَعُوا أَمْرَهُمْ وَهُمْ  
يَمْكُرُونَ ﴿١٠٤﴾

وَمَا أَكْثَرُ النَّاسِ وَلَوْ حَرَصْتَ  
بِمُؤْمِنِينَ ﴿١٠٥﴾

وَمَا تَسْأَلُهُمْ عَلَيْهِ مِنْ أَجْرٍ ۗ إِنْ هُوَ  
إِلَّا ذِكْرٌ لِلْعَالَمِينَ ﴿١٠٦﴾

وَكَانَ مِنْ آيَاتِ فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ  
يَمُرُّونَ عَلَيْهَا وَهُمْ عَنْهَا مُعْرِضُونَ ﴿١٠٧﴾

وَمَا يُؤْمِنُ أَكْثَرُهُمْ بِاللَّهِ إِلَّا وَهُمْ  
مُشْرِكُونَ ﴿١٠٨﴾

أَفَأَمِنُوا أَنْ تَأْتِيَهُمْ غَاشِيَةٌ مِنْ عَذَابِ  
اللَّهِ أَوْ تَأْتِيَهُمُ السَّاعَةُ بَغْتَةً وَهُمْ  
لَا يَشْعُرُونَ ﴿١٠٩﴾

قُلْ هَذِهِ سَبِيلِي أَدْعُوا إِلَى اللَّهِ ۖ عَلَى  
بَصِيرَةٍ أَنَا وَمَنِ اتَّبَعَنِي ۗ وَسُبْحَانَ اللَّهِ  
وَمَا أَنَا مِنَ الْمُشْرِكِينَ ﴿١١٠﴾

وَمَا أَرْسَلْنَا مِنْ قَبْلِكَ إِلَّا رِجَالًا نُوحِي  
إِلَيْهِمْ مِنْ أَهْلِ الْقُرَى ۗ أَفَلَمْ يَسِيرُوا

(Njerëzit) a nuk shëtisin në tokë që të shikojnë se si ka qenë fundi i atyre që ishin më parë?! Dhe sigurisht, shtëpia e *ahiretit* është më e mirë për ata që kanë drojë (ndaj Allahut). Pra, a nuk kuptoni?!

111. Aq saqë kur të Dërguarit u dëshpëruan (prej tyre) dhe (njerëzit) menduan se janë gënjyer,<sup>11</sup> atyre u erdhi ndihma Jonë. Kështu, shpëtoi ai që Ne deshëm. Dhe ndëshkimi Ynë nuk zmbropset nga njerëzit fajtorë.

112. Njëmend, në historitë e tyre ka një mësim për njerëzit e mençur. Kjo nuk është ndonjë fjalë e trilluar, por është vërtetuese e asaj që e ka përpara, shpjegim për çdo gjë, udhëzim dhe mëshirë për njerëzit që besojnë.

فِي الْأَرْضِ فَيَنْظُرُوا كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ  
الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ ۗ وَلَدَارُ الْآخِرَةِ خَيْرٌ  
لِلَّذِينَ اتَّقَوْا ۗ أَفَلَا تَعْقِلُونَ ﴿١١١﴾

حَتَّىٰ إِذَا اسْتَيْسَسَ الرُّسُلُ وَظَنُّوا أَنَّهُمْ قَدْ  
كُذِّبُوا جَاءَهُمْ نَصْرُنَا ۗ فَنَبِّئُكَ مِمَّنْ نَشَاءُ ۗ  
وَلَا يَرُدُّ بَأْسَنَا عَنِ الْقَوْمِ الْمَجْرِمِينَ ﴿١١٢﴾

لَقَدْ كَانَ فِي قَصَصِهِمْ عِبْرَةٌ لِأُولِي  
الْأَلْبَابِ ۗ مَا كَانَ حَدِيثًا يُفْتَرَىٰ وَلَكِنْ  
تَصْدِيقَ الَّذِي بَيْنَ يَدَيْهِ وَتَفْصِيلَ كُلِّ  
شَيْءٍ ۗ وَهُدًى وَرَحْمَةً لِّقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ ﴿١١٣﴾

11. Fjala "kudhibu" do të thotë ata u gënjyen dhe këtu do të thotë se njerëzit menduan se Profetët i kanë gënjyer. E kur Profetëve u erdhi ndihma e Allahut, edhe njerëzit kuptuan se gjithçka që thanë ata, ishte e vërtetë.

## Surja 13 – Er-Ra’d

Surja Er-Ra’d është mekase dhe bashkë me *bismil-lahin*, ka dyzet e katër ajete.

Në shkurtesat e kësaj sureje, për dallim nga suret e mëparshme, ka një shkronjë shtesë. Ato janë *elif-lam-mim-ra*, që do të thotë: “Unë jam Allahu, di dhe shoh”.

Kjo sure zbulon disa sekrete të universit, të cilat Profeti Muhammed<sup>savs</sup> nuk mund t’i dinte vetë. Edhe ky fakt vërteton se edhe historitë që janë treguar në suret e mëparshme, pa dyshim janë treguar nga i Gjithëdijshti i së padukshmes.

Një prej sekreteve kryesore të gjithësisë që është përmendur në këtë sure është forca e gravitetit. Surja thotë se trupat qiellorë jo rastësisht qëndrojnë në orbitat e tyre, por mes tyre vepron një forcë e fshehtë, të cilën nuk e shihni dot me sy. E tillë është kjo forcë saqë duket sikur trupat qiellorë po qëndrojnë nëpër shtylla. Mjafton të themi se kozmologët kështu e shpjegojnë gravitetin.

Një tjetër temë e rëndësishme që përmend kjo sure është se si Allahu i Madhërishëm i dha jetë çdo gjëje me ujë të përshtatshëm. Uji i detit është tepër i kripur, prandaj, gjallesat dhe bimësia e tokës, në vend që të fitonin jetë, do të shkatërroheshin duke e konsumuar atë. Kjo sure flet për sistemin e vaditjes sesi i njëjti ujë merret, kullohet dhe çohet nëpër male dhe prej andej bëhet që ai të zbresë dhe të bjerë në formë shiu dhe të shkojë sërish te deti, por duke përhapur anekënd jetë dhe lulëzim. Ky sistem vaditjeje është i lidhur ngushtësisht edhe me vetëtimat, të cilat shkaktohen kur ujërat e oqeanëve avullohen. Gjithashtu edhe shirat nuk mund të binin pa qenë vetëtimat në mes të reve. Gjëmimi i vetëtimave nganjëherë është kaq i fuqishëm saqë, për disa ai mund të jetë edhe vdekjeprurës. Prandaj, në këtë sure thuhet se në një kohë të tillë, engjëjt përkulen nga frika para Allahut të Madhërishëm. Përpara kësaj, Zoti i Madhërishëm flet edhe për sistemin imunitar të njeriut, duke thënë se para dhe mbrapa tij qëndrojnë rojtarë, të cilët e mbrojnë njeriun me caktimin dhe urdhrin e Allahut. Kjo është një temë shumë e thellë shkencore, të cilën nuk mund ta shtjellojmë dot këtu, por kushdo që ka aftësi, mund të thellohet në të për të marrë perla urtësie të saj.

Kjo sure gjithashtu thotë se Zoti i Madhërishëm ka krijuar çdo gjë në çift. Hurmat kanë çifte, deri këtu arabët e dinin, por ata nuk mund të kishin njohuri se edhe pemët dhe frutat e tjera gjithashtu kanë çiftet e tyre. Andaj, kjo ishte një temë e re, të cilën shkencëtarët e sotëm arritën ta kuptonin aq thellë saqë, për ta, jo vetëm që gjallesat dhe bimët janë në çifte, por edhe molekulat dhe atomet kanë çiftet e tyre. Edhe materia ka çiftin e saj që quhet anti-materie. Si të thuash, nëse paloset e gjithë gjithësia, materia mund të asgjësohet duke u bashkuar me anti-materien e saj. Me këto ajete gjithashtu nënkuptohet çështja e krijimit nga asgjëja.

Pas kësaj, për ta çuar argumentin deri në fund ndaj armiqve të Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, jepet një provë madhështore duke thënë se ky Profet madhështor dhe sahabët e tij nuk

mund të mposhten, sepse toka e tyre po vjen duke u zgjeruar, kurse kundërshtarëve të tyre po u vjen duke u zvogëluar. Pas kësaj, *Hazret Profetit Muhammed<sup>savs</sup>* i jepet qetësi duke thënë se nuk ka rëndësi nëse ti arrin apo nuk arrin ta shohësh fitoren madhështore të Islamit, por Ne kemi marrë përsipër ta bëjmë fenë tënde të triumfojë gjithë botën.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. *Elif.Lam.Mim.Ra.* (Unë jam Allahu që di dhe shoh.) Këto janë ajetet e Librit dhe është ajo e vërtetë që Zoti yt të zbriti ty, por shumica e njerëzve nuk besojnë.

الْمَرِّ ۚ تِلْكَ آيَاتُ الْكِتَابِ ۚ وَالَّذِي أُنزِلَ  
إِلَيْكَ مِنْ رَبِّكَ الْحَقُّ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ  
لَا يُؤْمِنُونَ ①

3. Allahu është Ai që ngriti qiejt pa ndonjë shtyllë që mund ta shihnit,<sup>1</sup> më pas u vendos mbi Arsh,<sup>2</sup> dhe vuri në shërbim diellin dhe hënën. Çdo gjë lëviz për një afat të caktuar. Ai planifikon çështjen (dhe) shpjegon shenjat që ju të bindeni për takimin me Zotin tuaj.

اللَّهُ الَّذِي رَفَعَ السَّمَوَاتِ بِغَيْرِ عَمَدٍ تَرَوْنَهَا  
ثُمَّ اسْتَوَىٰ عَلَى الْعَرْشِ وَسَخَّرَ الشَّمْسَ  
وَالْقَمَرَ ۚ كُلٌّ يَجْرِي لِأَجَلٍ مُّسَدَّدٍ ۚ  
يُدِيرُ الْأَمْرَ يَفْصَلُ الْآيَاتِ لَعَلَّكُمْ بِلِقَاءِ  
رَبِّكُمْ تُوقِنُونَ ①

4. Dhe është Ai që shtroi tokën dhe vendosi në të male dhe lumenj; dhe çdo frutë bëri në çift, nga dy gjini; Ai mbulon ditën me natën. Sigurisht, në to ka shenja për njerëzit që mendojnë.

وَهُوَ الَّذِي مَدَّ الْأَرْضَ وَجَعَلَ فِيهَا  
رَوَابِي وَأَنْهَارًا ۚ وَمِنْ كُلِّ الشَّجَرِ جَعَلَ  
فِيهَا زَوْجَيْنِ اثْنَيْنِ يُغْشَىٰ اللَّيْلَ النَّهَارَ ۚ  
إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِّقَوْمٍ يَتَفَكَّرُونَ ①

5. Dhe në tokë ka troje të lidhura me njëra-tjetrën, vreshta me rrush, ara, hurma binjake dhe jobinjake; ujiten (të gjitha) me të njëjtin ujë. Disave u kemi dhënë epërsi në shije mbi disa të tjera. Sigurisht, në to ka shenja për njerëzit që kuptojnë.

وَفِي الْأَرْضِ قِطْعٌ مُّتَجَوِّرٌ ۚ وَجُدَّتْ  
مِنَ الْأَعْنَابِ ۚ وَزُرْعٌ وَنَخِيلٌ صَوَانٌ  
وَغَيْرُ صَوَانٍ يُسْقَىٰ بِمَاءٍ وَاحِدٍ ۚ  
وَنُفَّصِلُ بَعْضَهَا عَلَىٰ بَعْضٍ فِي الْأَكْلِ ۚ  
إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِّقَوْمٍ يَعْقِلُونَ ①

1. Lexoni shpjegimin në parathënien e sures.

2. Për Arshin, lexoni 7:55.

6. Nëse çuditësh, e çuditshme është edhe thënia e tyre: “Kur do të bëhemi dhé, a do të jemi (sërisht) në një jetë të re?!” Pikërisht këta e mohuan Zotin e tyre dhe pikërisht këta do të kenë pranga nëpër qafë. Dhe pikërisht këta janë banorët e zjarrit, në të cilin do të mbesin gjatë.

7. Ata të kërkojnë nxitimthi të keqen përpara së mirës, ndërkohë që kanë kaluar shembujt e ndëshkimeve përpara tyre. Pa dyshim, Zoti yt ka shumë falje për njerëzit karshi padrejtësisë së tyre. Pa dyshim, Zoti yt është i fortë në ndëshkim.

8. Ata që mohuan thonë: “Përse nuk u zbrit mbi të ndonjë shenjë prej Zotit të tij?” Pa dyshim, ti je vetëm një alarmues, dhe për çdo popull ka një udhëzues.<sup>3</sup>

9. Allahu e di çfarë mbart çdo femër dhe atë që e pakësojnë mitrat si dhe atë që e teprojnë. Çdo gjë tek Ai është e llogaritur.

10. Ai është i Dijshmi i së padukshmes dhe i së dukshmes, i Madhi, i Lartësuari!

11. Njësoj është (për Të) prej jush ai që e fshehu fjalën, ai që e shfaqti atë, ai që është i fshehur gjatë natës dhe ai që lëviz lirshëm gjatë ditës.

وَإِنْ تَجِبْ فَحَبِّبْ قَوْلَهُمْ ۚ إِذَا كُنَّا تُرَابًا  
 ۚ إِنَّا نَفِي خَلْقٍ جَدِيدٍ ۚ أُولَٰئِكَ الَّذِينَ  
 كَفَرُوا بِرَبِّهِمْ ۚ وَأُولَٰئِكَ الْأَعْلَىٰ فِي  
 أَعْنَاقِهِمْ ۚ وَأُولَٰئِكَ أَصْحَابُ النَّارِ ۚ هُمْ فِيهَا  
 خَالِدُونَ ﴿١٠﴾

وَيَسْتَعْجِلُونَكَ بِالسَّيِّئَةِ قَبْلَ الْحَسَنَةِ  
 وَقَدْ خَلَتْ مِنْ قَبْلِهِمُ الْمَثَلُت ۗ وَإِنَّ  
 رَبَّكَ لَذُو مَغْفِرَةٍ لِّلنَّاسِ عَلَىٰ ظُلْمِهِمْ ۚ  
 وَإِنَّ رَبَّكَ لَشَدِيدُ الْعِقَابِ ﴿١١﴾

وَيَقُولُ الَّذِينَ كَفَرُوا لَوْلَا نُزِّلَ عَلَيْهِ  
 آيَةٌ مِنْ رَبِّهِ ۗ إِنَّمَا أَنْتَ مُنذِرٌ وَ لِكُلِّ  
 قَوْمٍ هَادٍ ﴿١٢﴾

اللَّهُ يَعْلَمُ مَا تَحْمِلُ كُلُّ أُنْثَىٰ وَمَا تَغِيصُ  
 الْأَرْحَامُ وَمَا تَرْدَادُ ۗ وَكُلُّ شَيْءٍ عِنْدَهُ  
 بِمِقْدَارٍ ﴿١٣﴾

عَلِمَ الْغَيْبِ وَالشَّهَادَةِ الْكَبِيرِ الْمُتَعَالِ ﴿١٤﴾

سَوَاءٌ مِنْكُمْ مَنْ أَسْرَ الْقَوْلَ وَمَنْ جَهَرَ  
 بِهِ وَمَنْ هُوَ مُسْتَخْفٍ بِاللَّيْلِ وَسَارِبٌ  
 بِالنَّهَارِ ﴿١٥﴾

3. Lexoni 35:25; 1:2; 14:10.

12. Ka rojtarë për të, përpara dhe pas tij, (që) e mbrojnë atë me urdhrin e Allahut.<sup>4</sup> Sigurisht, Allahu nuk i ndryshon gjendjen një populli, derisa ata nuk e ndryshojnë gjendjen e tyre. Dhe kur Allahu vendos t'i shkaktojë ndonjë populli një të keqe (si pasojë), s'ka kush që e largon atë dhe ata nuk kanë asnjë ndihmës përveç Atij.

13. Është Ai që ju tregon vetëtimën për frikë dhe shpresë dhe ngre retë e rënduara.

14. Bubullima përkujton (Atë) me lavdinë e Tij, edhe engjëjt (e përkujtojnë Atë) nga frika ndaj Tij. Ai dërgon bubullima të forta, që përmes tyre të godasë kë të dojë. Ndërsa ata grinden në lidhje me Allahun, Ai është i fortë në kapje.

15. Atij i bëhet lutja e vërtetë. Kurse ata që u luten të tjerëve përveç Atij, nuk u përgjigjen për asgjë, madje janë porsia ai që i shtrin duart drejt ujit, që ai ta arrijë gojën e tij, por ai nuk ka për ta arritur. Lutja e mohuesve shkon vetëm në humbje.

16. Allahut i bën sexhde kushdo që është nëpër qiej dhe tokë, me hir e pahir, dhe edhe hijet e tyre gjatë mëngjesit dhe mbrëmjeve.<sup>5</sup>

Sexhdeja II

لَهُ مُعَقِّبَاتٌ مِّنْ بَيْنِ يَدَيْهِ وَمِنْ خَلْفِهِ  
يَحْفَظُونَهُ مِنْ أَمْرِ اللَّهِ ۗ إِنَّ اللَّهَ لَا يُغَيِّرُ  
مَا يَقُومُ حَتَّىٰ يُغَيِّرُوا مَا بِأَنفُسِهِمْ ۗ وَإِذَا  
أَرَادَ اللَّهُ بِقَوْمٍ سُوءًا فَلَا مَرَدَّ لَهُ ۗ  
وَمَا لَهُمْ مِّنْ دُونِهِ مِنْ وَالٍ ﴿١٥﴾

هُوَ الَّذِي يُرِيكُمُ الْبَرْقَ حَوَافًا وَ طَمَعًا  
وَيُنشِئُ السَّحَابَ الثِّقَالَ ﴿١٦﴾

وَيَسِّحُ الرِّعْدَ بِحِمِّهِ وَالْمَلَكَةَ مِنْ  
خِيفَتِهِ ۗ وَيُرْسِلُ الصَّوَاعِقَ فَيُصِيبُ بِهَا  
مَنْ يَشَاءُ ۗ وَهُمْ يُجَادِلُونَ فِي اللَّهِ ۗ وَهُوَ  
شَدِيدُ الْحَالِ ﴿١٧﴾

لَهُ دَعْوَةُ الْحَقِّ ۗ وَاللَّذِينَ يُدْعُونَ مِنْ دُونِهِ  
لَا يَسْتَجِيبُونَ لَهُمْ بِشَيْءٍ إِلَّا كَبَاسِطٍ  
كَفَيْهِ إِلَى الْمَاءِ لِيَبْلُغَ فَاهُ وَمَا هُوَ  
بِالْبَاحِ ۗ وَمَا دَعَاءُ الْكٰفِرِينَ إِلَّا فِي  
صَلٰٓئِ ۙ ﴿١٨﴾

وَاللَّهُ يَسْجُدُ مَنْ فِي السَّمٰوٰتِ وَالْأَرْضِ  
طَوْعًا وَ كَرْهًا وَظَلَمَهُم بِالْعَدُوِّ  
وَالْأَصَالِ ﴿١٩﴾

Sexhdeja III

4. Ky ajet ndër të tjera flet edhe për sistemin imunitar të njeriut, duke thënë se para dhe mbrapa tij qëndrojnë rojtarë, të cilët e mbrojnë njeriun me caktimin dhe urdhrin e Allahut.

5. Ky ajet flet për një të vërtetë të madhe: i gjithë krijimi është i detyruar t'u bindet ligjeve të natyrës të krijuara nga Zoti, me hir e pa hir. Për shembull, gjuha duhet të kryejë funksionin e shijimit e jo të dëgjimit; veshi është i obliguar të kryejë funksionin e dëgjimit dhe jo të të



17. Pyet: Kush është Zoti i qiejve dhe i tokës? Thuaj: Allahu. Pyet: A keni marrë për miq të tjerët përveç Atij, që as për veten e tyre nuk kanë fuqi për t'i sjellë as dobi e as dëm?! Pyet: A mund të jenë të barabartë i verbri dhe ai që sheh?! Ose a mund të jenë të barabarta errësirat dhe drita?! Apo kanë bërë ortakë për Allahun që krijuan sikur krijimi i Tij, saqë atyre u është ngatërruar krijimi?! Thuaj: Allahu është Krijuesi i çdo gjëje dhe Ai është i Vetmi, Mbizotëruesi.<sup>6</sup>

18. Ai zbriti prej qiellit ujë, në atë mënyrë që luginat rrodhën sipas fuqisë së tyre, atëherë rrjedha mbarti shkumën e sipërme. Edhe ajo që ata e djegin në zjarr që ta bëjnë stoli ose ndonjë mjet tjetër, ka një shkumë të ngjashme me të. Kështu Allahu përqsas të vërtetën dhe të rremen. Për sa i përket shkumës, ajo shkon pa dobi, kurse ai që u sjell dobi njerëzve, qëndron në tokë. Kështu Allahu i

قُلْ مَنْ رَبُّ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ط  
قُلِ اللَّهُ ط قُلْ أَفَاتَّخَذْتُمْ مِنْ دُونِهِ  
أَوْلِيَاءَ لَا يَمْلِكُونَ لِأَنفُسِهِمْ نَفْعًا  
وَلَا ضَرًّا قُلْ هَلْ يَسْتَوِي الْأَعْمَى  
وَالْبَصِيرُ أَمْ هَلْ تَسْتَوِي الظُّلُمَاتُ  
وَالنُّورُ أَمْ جَعَلُوا لِلَّهِ شُرَكَاءَ خَلَقُوا  
كَخَلْقِهِ فَتَشَابَهَ الْحَقُّ عَلَيْهِمْ ط قُلِ اللَّهُ  
خَالِقُ كُلِّ شَيْءٍ وَهُوَ الْوَاحِدُ الْقَهَّارُ ﴿٦﴾

أَنْزَلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَسَالَتْ أوديةً  
يَقْدِرُهَا فَاحْتَمَلَ السَّيْلُ زَبَدًا رَابِيًا ط  
وَمَا يُوقِدُونَ عَلَيْهِ فِي النَّارِ ابْتِغَاءَ حَلِيَّةٍ  
أَوْ مَتَاعٍ زَبَدٌ مِثْلُهُ ط كَذَلِكَ يَضْرِبُ اللَّهُ  
الْحَقَّ وَالْبَاطِلَ ط فَأَمَّا الزَّبَدُ فَيَذْهَبُ  
جُفَاءً ط وَأَمَّا مَا يَنْفَعُ النَّاسَ فَيَمْكُثُ  
فِي الْأَرْضِ ط كَذَلِكَ يَضْرِبُ اللَّهُ

parit, e me radhë. Kjo bindje ndaj ligjeve të natyrës mund të quhet e detyrueshme. Por njeriut i jepet një liri e caktuar veprimi ku ai mund të përdorë vullnetin dhe maturinë e tij. Por edhe në veprimet në të cilat duket se atij i është dhënë liria, ai i nënshtrohet disa ligjeve që janë të pashmangshme për të, pavarësisht nëse i pëlqen apo jo. Fjalët, me ose pa hir, mund t'u referohen gjithashtu dy kategorive të njerëzve: besimtarët që me dëshirë i nënshtrohen Zotit, dhe mohuesit që u binden ligjeve të Tij me pahir. Lexoni edhe 64:2. (Për lutjen në sexhden e leximit të Kuranit, shikoni 7:207.)

6. Kurani përdor dytribute të ndryshme për të përshkruar Njëshmërinë e Zotit: (1) *Ehad* (i Vetmi) dhe (2) *Vahid* (Një). Atributi i parë tregon Njëshmërinë e Tij absolute, pa e relativizuar me askënd dhe asgjë. Kurse i dyti tregon se Ai është i Pari ose Pikënisja dhe gjithçka tjetër vjen pas Tij. Kështu, atributi *Vahid* (Një) tregon se Zoti është Burimi i vërtetë i të gjitha krijesave dhe se çdo gjë e shënjon Atë, njësoj siç i dyti apo i treti shënjon të parin. Por, kur Kurani shpjegon Njëshmërinë e Zotit duke hedhur poshtë doktrinën se Ai të ketë bir ose ortak, të çfarëdo forme, e përshkruan me atributin *Ehad* (i Vetmi), që do të thotë se askush nuk ka qenë asnjëherë i barabartë me Të (112:2).

paraqet shembujt.<sup>7</sup>

19. Mirësia është për ata që i përgjigjen Zotit të tyre. Kurse ata që nuk i përgjigjen, edhe sikur të kenë gjithçka që ka toka dhe po aq si shtesë, do ta jepnin që të shlyheshin përmes saj. Pikërisht për këta ka llogaridhënie të keqe. Streha e tyre është xhehenemi. Sa strehë e keqe është ai!

20. Atëherë, ai që di se e vërteta është pikërisht ajo që të është zbritur ty prej Zotit tënd, a mund të jetë si ai që është i verbër?! Sigurisht, vetëm të mençurit mendohen;

21. ata që përmbushin premtimin e Allahut dhe nuk e thyejnë besëlidhjen;

22. dhe ata që lidhin atë që Allahu ka urdhëruar të lidhet, i frikësohen Zotit të tyre dhe frikësohen nga llogaridhënia e keqe;

23. dhe ata që durojnë duke kërkuar pëlqimin e Zotit të tyre, falin namazin, shpenzojnë fshehtas dhe haptas<sup>8</sup> nga ajo që Ne ua kemi dhënë dhe largojnë të keqen me të mirën. Pikërisht këta kanë fundin e (mbarë të) shtëpisë;

7. Ky ajet ka përdorur dy ilustrime shumë të goditura. Në ilustrimin e parë, e vërteta është krahasuar me ujin dhe gënjeshtera me shkumën. Gënjeshtera në fillim duket se mbizotëron mbi të vërtetën, por në fund ajo fshihet nga e vërteta, siç fshihen plehrat dhe shkuma nga vala e fuqishme e ujit. Në ilustrimin e dytë, e vërteta është krahasuar me arin, argjendin etj., të cilët, kur i shkrin, del zgjyra (shkuma), e ndarë nga metali i pastër dhe i ndritshëm.

8. Lexoni 2:275.

الْأَمْثَالُ ٧٨

لِلَّذِينَ اسْتَجَابُوا لِرَبِّهِمْ الْحُسْنَىٰ ٧٨  
وَالَّذِينَ لَمْ يَسْتَجِيبُوا لَهُ لَوْ أَنَّ لَهُمْ  
مَا فِي الْأَرْضِ جَمِيعًا وَمِثْلَهُ مَعَهُ  
لَافْتَدَوْا بِهِ ٧٩ أُولَٰئِكَ لَهُمْ سُوءُ الْحِسَابِ ٨٠  
وَمَا أُولَٰئِكَ بِمُعْتَدِبِينَ ٨١ وَمَا أُولَٰئِكَ بِمُعْتَدِبِينَ ٨٢

أَفَمَنْ يَعْلَمُ أَنَّمَا أُنزِلَ إِلَيْكَ مِنْ رَبِّكَ  
أَنَّهُ حَقٌّ كَمَنْ هُوَ أَعْلَىٰ ٨٣ إِنَّمَا يَتَذَكَّرُ  
أُولَٰئِكَ الْأَلْبَابُ ٨٤

الَّذِينَ يُؤْفِقُونَ بِعَهْدِ اللَّهِ وَلَا يَنْقُضُونَ  
الْمِيثَاقَ ٨٥

وَالَّذِينَ يَصِلُونَ مَا أَمَرَ اللَّهُ بِهِ أَنْ يُوصَلَ  
وَيَخْشُونَ رَبَّهُمْ وَيَخَافُونَ سُوءَ  
الْحِسَابِ ٨٦

وَالَّذِينَ صَبَرُوا ابْتِعَاءَ وَجْهِ رَبِّهِمْ  
وَأَقَامُوا الصَّلَاةَ وَأَنْفَقُوا مِمَّا رَزَقْنَاهُمْ  
سِرًّا وَعَلَانِيَةً وَيَذَرُونَ بِالْحَسَنَةِ  
السَّيِّئَةَ ٨٧ أُولَٰئِكَ لَهُمْ عُقْبَى الدَّارِ ٨٨

24. (pra) kopshte të përhershme, ku do të hyjnë ata, si dhe ai që u përmirësua nga mesi i baballarëve të tyre, grave të tyre dhe pasardhësve të tyre. Dhe engjëjt do të hyjnë te ta nga çdo derë.

جَتُّ عَدْنٍ يَدْخُلُونَهَا وَمَنْ صَلَحَ مِنْ  
أَبَائِهِمْ وَأَزْوَاجِهِمْ وَذُرِّيَّتِهِمْ وَالْمَلَائِكَةُ  
يَدْخُلُونَ عَلَيْهِمْ مِنْ كُلِّ بَابٍ ﴿٢٤﴾

25. “Paqe qoftë mbi ju, për shkak se duruat!” Sa i mbarë qenka fundi i shtëpisë!

سَلَامٌ عَلَيْكُمْ بِمَا صَبَرْتُمْ فَنِعْمَ عُقْبَى  
الدَّارِ ﴿٢٥﴾

26. Kurse ata që e thyejnë premtimin e Allahut, pasi e lidhën fort, (që) e këpusin atë që Allahu ka urdhëruar të lidhet dhe çrregullojnë në tokë; pikërisht për këta është mallkimi dhe për këta ka shtëpi të keqe.

وَالَّذِينَ يَتَّقُونَ عَهْدَ اللَّهِ مِنْ بَعْدِ  
مِيثَاقِهِ وَيَقْطَعُونَ مَا أَمَرَ اللَّهُ بِهِ أَنْ  
يُوصَلَ وَيُفْسِدُونَ فِي الْأَرْضِ ۗ أُولَٰئِكَ  
لَهُمُ اللَّعْنَةُ وَلَهُمْ سُوءُ الدَّارِ ﴿٢٦﴾

27. Allahu shton të mirat për kë të dojë dhe e pakëson. Ata u kënaqën me jetën e kësaj bote, kurse në *ahiret* jeta e kësaj bote do të mbetet vetëm një përfitim i shkurtër.

اللَّهُ يَبْسُطُ الرِّزْقَ لِمَنْ يَشَاءُ وَيَقْدِرُ ۗ  
وَفَرِحُوا بِالْحَيَاةِ الدُّنْيَا ۗ وَمَا الْحَيَاةُ الدُّنْيَا  
فِي الْآخِرَةِ إِلَّا مَتَاعٌ ﴿٢٧﴾

28. Ata që mohuan thonë: “Përse nuk u zbrit mbi të ndonjë shenjë prej Zotit të tij?!” Thuaj: Sigurisht, Allahu e cilëson të devijuar kë të dojë dhe udhëzon drejt Vetes së Tij (vetëm) atë që përulet;

وَيَقُولُ الَّذِينَ كَفَرُوا لَوْلَا أُنزِلَ عَلَيْهِ  
آيَةٌ مِنْ رَبِّهِ ۗ قُلْ إِنْ اللَّهُ يُضِلُّ مَنْ  
يَشَاءُ وَيَهْدِي ۗ إِلَيْهِ مَنْ أَنَابَ ﴿٢٨﴾

29. (pra) ata që besuan dhe (të cilëve) zemrat u qetësohen me përmendjen e Allahut. Dijeni! Zemrat qetësohen vetëm me përmendjen e Allahut!<sup>9</sup>

الَّذِينَ آمَنُوا وَتَطْمَئِنُّ قُلُوبُهُمْ بِذِكْرِ  
اللَّهِ ۗ أَلَا بِذِكْرِ اللَّهِ تَطْمَئِنُّ الْقُلُوبُ ﴿٢٩﴾

9. Kuptimi i parë i ajetit është që zemrat qetësohen vetëm me përmendjen e Allahut, por këto fjalë përmbajnë një realitet dhe filozofi të thellë. Kur njeriu e kujton Zotin me sinqeritet dhe besnikëri të plotë, kur gjatë gjithë kohës është i bindur se ai qëndron përpara Zotit, zemra e tij ndien madhësitinë e Tij dhe, duke pasur druajtje ndaj Tij, ai ruhet nga mëkatet dhe ligësitë, përparon në druajtjen ndaj Tij dhe në delirësi. Kështu vijon, derisa atij i zbresin engjëjt e Zottit

30. Ata që besuan dhe bënë të mira, kanë një vend të pastër dhe vendkthim të mbarë.

31. Kështu Ne të dërguam në një popull, para të cilit kanë kaluar shumë popuj, që ti t'ua lexosh atyre atë që të kemi shpallur, ndërkohë që ata e mohojnë të Gjithëmëshirshmin. Thuaj: Ai është Zoti im, nuk ka të adhurueshëm tjetër përveç Atij. Tek Ai jam mbështetur dhe drejt Atij është përlujta ime.

32. Edhe sikur të ishte një Kuran me të cilin të lëviznin malet ose të çahet toka ose të flisnin të vdekurit, (ata prapë do të dyshonin). E vërteta është që vendimi i gjithi i takon Allahut. Prandaj, ata që besuan a nuk ditën se po të donte Allahu, do t'i udhëzonte njerëzit që të gjithë?! Atyre që mohuan, vazhdimisht do t'u trokasë gjëma, për shkak të asaj që punuan, ose ajo do t'u bjerë afër shtëpive të tyre, derisa të vijë premtimi i Allahut. Sigurisht, Allahu nuk e shkel premtimin.

33. Edhe para teje u përqeshën (shumë) të dërguar, atëherë Unë u dhashë afat atyre që mohuan, më pas i zura. Vëreni se si ishte ndëshkimi Im!

الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ طُوبَىٰ لَهُمْ  
وَحَسَنُ مَا بِ ۝

كَذَٰلِكَ أَرْسَلْنَا فِي أُمَّةٍ قَدْ خَلَتْ مِن  
قَبْلِهَا أُمَمٌ لِّتَتْلُوَ عَلَيْهِمُ الَّذِي أَوْحَيْنَا  
إِلَيْكَ وَهُمْ يَكْفُرُونَ بِالرَّحْمَنِ ۗ قُلْ هُوَ  
رَبِّي لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ ۗ عَلَيْهِ تَوَكَّلْتُ وَإِلَيْهِ  
مَتَابٌ ۝

وَلَوْ أَنَّ قُرْآنًا سُيِّرَتْ بِهِ الْجِبَالُ أَوْ  
قُطِعَتْ بِهِ الْأَرْضُ أَوْ كَلِمَةٌ بِهِ الْمَوْتَىٰ ۗ  
بَلْ لِّلَّهِ الْأَمْرُ جَمِيعًا ۗ أَفَلَمْ يَأْتِ  
الَّذِينَ آمَنُوا أَن لَّوْ يَشَاءُ اللَّهُ لَهْدَى  
النَّاسَ جَمِيعًا ۗ وَلَا يَرَىٰ الَّذِينَ كَفَرُوا  
لِئَصِيبَهُمْ بِمَا صَعَوْا قَارِعَةً أَوْ تَحُلُّ  
قَرِيبًا مِّن دَارِهِمْ حَتَّىٰ يَأْتِيَ وَعْدَ اللَّهِ ۗ  
إِنَّ اللَّهَ لَا يَخْلِفُ الْمِيعَادَ ۝

وَلَقَدْ اسْتَهْزَيْتُمْ بِرُسُلِنَا مِن قَبْلِكَ  
فَأَمَلَيْتُمُ لِلَّذِينَ كَفَرُوا ثُمَّ أَخَذْنَاهُم  
فَكَيْفَ كَانَ عِقَابِ ۝

që i japin lajme të mira, i hapin rrugën e komunikimit me Zotin përmes ëndrrave të vërteta, shpalljes dhe *keshfit*. Atëherë, si të thuash, ai e sheh Allahun e Madhërishëm, dhe sipas aftësisë që ka, dëshmon fuqitë e përtejme të Zotit. Në këtë fazë, e cila është grada e Profetëve, njeriu nuk ka asnjë brengë, dhe zemra e tij në çdo situatë është e lumtur. Kështu, kënaqësia më e madhe, të pavarëson nga kënaqësitë e vogla. Realisht, njeriu e ka në gjenezën e tij kërkimin e Zotit, dhe ky pikërisht është edhe objektivi kryesor i jetës së tij. Kur e arrin këtë objektivi, njeriu përjeton paqen dhe lumturinë e vërtetë, sepse ai qetësohet në prehjen e Krijuesit.

34. Pra, a nuk është (i denjë për llogarimarrje) Ai që qëndron në krye të çdo shpirti se çfarë punoi ai?! Ata i bënë ortakë Allahut. Thuaj: Emërtojini ata! Apo njoftoni Atë diçka për të cilën Ai nuk di (gjë) në tokë?! Apo këto (që thoni) janë vetëm fjalë boshe?! E vërteta është që ata që mohuan, intrigat e tyre iu dukën joshëse dhe (për këtë) ata u ndaluan nga rruga (e drejtë). Atë që Allahu e cilëson të devijuar, nuk ka më ndonjë udhëzues për të.

35. Ata do të kenë ndëshkim në jetën e kësaj bote, kurse ndëshkimi i *ahiretit* është më i rëndi. Ata nuk do të kenë ndonjë shpëtimtar përveç Allahut.

36. Shembulli i xhenetit që iu premtua të druajturve (ndaj Zotit) është (si ai që) nëpër të cilin rrjedhin lumenj. Fryti i tij është i përhershëm, gjithashtu dhe hija e tij. Ky është fundi i atyre që kanë drojë (ndaj Allahut), kurse fundi i mohuesve është zjarri.<sup>10</sup>

37. Ata të cilëve u kemi dhënë Librin, gëzohen nga ajo që të është zbritur ty, dhe prej grupeve ka të tillë që e mohojnë pjesërisht. Thuaj: Unë jam urdhëruar të adhuroj vetëm Allahun dhe të mos i atribuoj asnjë ortak Atij. Drejt Atij thërras dhe drejt Atij kthehem.

أَفَمَنْ هُوَ قَائِمٌ عَلَى كُلِّ نَفْسٍ بِمَا كَسَبَتْ ۗ وَجَعَلُوا لِلَّهِ شُرَكَاءَ ۗ قُلْ سَمُّوهُمْ ۗ أَمْ تُنَبِّئُونَهُ بِمَا لَا يَعْلَمُ فِي الْأَرْضِ ۗ أَمْ يَظَاهِرُونَ مِنَ الْقَوْلِ ۗ بَلْ رُؤِينَ لِلَّذِينَ كَفَرُوا مَكْرَهُمْ ۗ وَصُدُّوا عَنِ السَّبِيلِ ۗ وَمَنْ يُضِلِلِ اللَّهُ فَمَا لَهُ مِنْ هَادٍ ۝

لَهُمْ عَذَابٌ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا ۗ وَعَذَابٌ الْأٰخِرَةِ ۗ أَسْخَقَ ۗ وَمَا لَهُمْ مِنَ اللَّهِ مِنْ وَّاقٍ ۝

مَثَلُ الْجَنَّةِ الَّتِي وُعدَ الْمُتَّقُونَ ۗ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ ۗ أَكْلُهَا دَائِمٌ ۗ وَظِلُّهَا ۗ تِلْكَ عُقْبَى الَّذِينَ اتَّقَوْا ۗ وَعُقْبَى الْكٰفِرِينَ النَّارُ ۝

وَالَّذِينَ آتَيْنَاهُمُ الْكِتَابَ يَفْرَحُونَ بِمَا أُنزِلَ إِلَيْكَ ۗ وَمِنَ الْأَحْرَابِ مَنْ يُنْكِرُ بَعْضَهُ ۗ قُلْ إِنَّمَا أُمِرْتُ أَنْ أَعْبُدَ اللَّهَ ۗ وَلَا أُشْرِكُ بِهِ ۗ إِلَيْهِ أَدْعُوا ۗ وَإِلَيْهِ مَابٍ ۝

10. Fjalët "Fryti i tij është i përhershëm", nënkuptojnë se frutat e xhenetit nuk do të kalben dhe as nuk do të vyshken. *Fryti* dhe *hija* respektivisht nënkuptojnë edhe bekimet e brendshme dhe të jashtme, dhe nënkuptojnë se besimtarët do të gëzojnë të gjitha llojet e bekimeve në xhenet, si të jashtme ashtu edhe të brendshme. Për kopshtet dhe lumenjtë e xhenetit, lexoni 2:26.

38. Po kështu, atë e kemi zbritur si porosi të qartë elokumente. Nëse ndjek dëshirat e tyre, pasi të ka ardhur dija, nuk do të kesh prej Allahut asnjë mik dhe asnjë shpëtimtar.

39. Kemi dërguar të dërguar edhe para teje dhe atyre u dhëmë bashkëshorte dhe pasardhës. Për asnjë të dërguar nuk ishte e mundur që të sillte ndonjë shenjë, përveçse me urdhrin e Allahut. Për çdo kohë ka një dekret.

40. Allahu fshin dhe vendos çfarë të dojë. Tek Ai është burimi i dekreteve.

41. Nëse të tregojmë ty disa nga paralajmërimet që u kemi bërë ose të marrim ty shpirtin, (në çdo rast) ti ke përgjegjësinë vetëm të kumtimit dhe Ne kemi përgjegjësinë e llogarimarrjes.

42. A nuk kanë parë ata që Ne po vijmë duke e pakësuar tokën nga anët e saj?! Allahu vendos; nuk ka kush që e kthen mbrapsht vendimin e Tij dhe Ai është i shpejtë në llogari.

43. Kanë qenë edhe para tyre ata që bënë strategji. E Allahut është e gjithë strategjia. Ai di se çfarë punon çdo shpirt. Dhe mohuesit patjetër do të dinë se kujt i takon fundi (i mbarë) i shtëpisë.

وَكَذَلِكَ أَنْزَلْنَاهُ حُكْمًا عَرَبِيًّا ۗ وَلَئِنْ  
اتَّبَعْتَ أَهْوَاءَهُمْ بَعْدَ مَا جَاءَكَ مِنَ  
الْعِلْمِ ۗ مَا لَكَ مِنَ اللَّهِ مِنْ وَلِيٍّ وَلَا  
عَاقِبَةٍ ۝

وَلَقَدْ أَرْسَلْنَا رُسُلًا مِّن قَبْلِكَ وَجَعَلْنَا  
لَهُمْ أَزْوَاجًا وَذُرِّيَّةً ۗ وَمَا كَانَ لِرَسُولٍ  
أَنْ يَأْتِيَ بِآيَةٍ إِلَّا بِإِذْنِ اللَّهِ ۗ لِكُلِّ  
أَجَلٍ كِتَابٌ ۝

يَمْحُوا اللَّهُ مَا يَشَاءُ وَيُثَبِّتُ ۗ وَعِنْدَهُ  
أُمُّ الْكِتَابِ ۝

وَإِنْ مَا تُرِيدُكَ بَعْضَ الَّذِي نَعِدُهُمْ أَوْ  
تَوَفِّيْنَاكَ فَإِنَّمَا عَلَيْكَ الْبَلَاغُ وَعَلَيْنَا  
الْحِسَابُ ۝

أَوَلَمْ يَرَوْا أَنَّا نَأْتِي الْأَرْضَ نَنْقُصُهَا مِنْ  
أَطْرَافِهَا ۗ وَاللَّهُ يَحْكُمُ لَا مُعَقِّبَ  
لِحُكْمِهِ ۗ وَهُوَ سَرِيعُ الْحِسَابِ ۝

وَقَدْ مَكَرَ الَّذِينَ مِن قَبْلِهِمْ فَلِلَّهِ  
الْمَكْرُ جَمِيعًا ۗ يَعْلَمُ مَا تَكْسِبُ كُلُّ نَفْسٍ ۗ  
وَسَيَعْلَمُ الْكُفْرُ لِمَنْ عُقِبِيَ الدَّارِ ۝

44. Dhe ata që mohuan thonë: “Ti nuk je i dërguar”. Thuaj: Allahu mjafton si Dëshmitar mes meje dhe mes jush,<sup>11</sup> si dhe ai që ka dijen e Librit.

وَيَقُولُ الَّذِينَ كَفَرُوا لَسْتَ مُرْسَلًا قُلْ  
 كَفَىٰ بِاللَّهِ شَهِيدًا بَيْنِي وَبَيْنَكُمْ ۗ وَمَنْ  
 عِنْدَهُ عِلْمُ الْكِتَابِ ۚ

11. Profeti Muhammed<sup>saws</sup> kur deklaroi të ishte Profet i Zotit, ai nuk ishte pa shenja. Kur mohuesit i kërkuan shenja që të vërtetonte se ai ishte prej Allahut, Profeti iu përgjigj – unë kam dy dëshmi: Allahun, pra pranimin e lutjeve dhe shumë shenja të tjera të freskëta prej Tij që qëndrojnë në mbështetjen time; dhe së dyti, ata që kanë dije rreth Librit të Allahut mund të tregojnë vërtetësinë time. Ky ajet gjithashtu tregon se për Profetin nuk mjafton vetëm të deklarohet se Zoti i ka dërguar shpallje, por ai duhet ta ketë me vete edhe dëshminë e Zotit me vepra konkrete.

## Surja 14 – Ibrahim

Surja Ibrahim është mekase dhe bashkë me *bismil-lahin*, ka pesëdhjetë e tri ajete.

Edhe kjo sure fillon me shkurtesat që janë të njëjta me suren Junus, pra *Elif-lam-ra*, shpjegimi i të cilave u përmend në parathënien e sures Junus.

Surja paraardhëse u mbyll me ajetin: “Ata që mohuan thonë: “Ti nuk je i dërguar”. Thuaj: Allahu mjafton si Dëshmitar mes meje dhe mes jush, si dhe ai që ka dijen e Librit”.

Për këtë arsye, edhe kjo sure që në fillim e përmend Librin dhe, duke treguar njëren prej arsyeve të zbritjes së tij, thotë, që njerëzit të dalin nga errësitat dhe të shkojnë drejt dritës. Gjithashtu, thuhet se po për këtë arsye edhe *Hazret Musait<sup>as</sup>* i ishte dhënë Libri. Më pas vjen paralajmërimi i *Hazret Musait<sup>as</sup>* që ai i bëri popullit të vet duke thënë: Nëse ju dhe të gjithë banorët e tokës më mohojnë, Allahu është i Pavarur nga mohimi juaj, pra nëse nuk do ta lavdëroni Atë, Ai në Vetvete është i Lavdishëm.

Më pas flitet për profetë të ndryshëm dhe se pse popujt e tyre i mohuan ata. “Argumenti” kryesor ku ata u bazuan në mohimin e tyre është që të Dërguarit janë si gjithë njerëzit e thjeshtë, të cilëve, sipas tyre, nuk mund t’u vinin shpallje prej Zotit.

Kjo sure përmend edhe një gjë të re dhe ajo është në lidhje me dënimin e renegatit (apostatit). Në këtë sure thuhet se janë mohuesit e të Dërguarve të cilët unanimisht binin në ujdj për të dënuar renegatët. Kështu që, çdo të dërguar ata e pandehnin si renegat dhe thuhet se e paralajmëronin se do ta dëbonin nga toka, derisa ai vetë nuk kthehej në besimin e tyre. Atëherë, Allahu i Madhërishëm u dërgon shpallje të Dërguarve të Tij se ata që pretendojnë t’i shkatërrojnë Profetët e Tij, do të shkatërrohen vetë, madje edhe tokat që sundojnë ata, do t’i trashëgojnë të Dërguarit e Zotit.

Kjo sure jep një shpjegim sublim të fjalës “*kelime*” (fjalë) dhe “*shexhere*” (pemë). Pema e pastër shëmbëllet me njerëzit e pastër, pra me Profetët, të cilët i kanë rrënjët në tokë, por ushqimin shpirtëror e marrin nga qielli dhe, në çdo situatë dhe në çdo stinë, e gëzojnë këtë ushqim. Kurse pema e keqe shëmbëllet me kundërshtarët e Profetëve, të cilët çrrënjosen nga toka dhe flaken në atë mënyrë, sikur një bimë e brishtë që e merr era. Kjo erë e çon një bimë të tillë nga një vend në tjetrin, pa gjetur qetësi. Kështu mbetet edhe gjendja e mohuesve të Profetëve. Ata vazhdimisht do të ndryshojnë pikëpamjet e tyre gjersa të shkatërrohen.

Pas kësaj përmendet lutja e *Hazret Ibrahimit<sup>as</sup>* në lidhje me Qaben, në të cilën ai i lutet Zotit të Madhërishëm që njerëzit që do të banonin rreth saj, t’i begatojë me fruta nga më të ndryshmet. Lutja e tij u pranua dhe Meka u bë pritëse edhe e frutave fizike, edhe e atyre shpirtërore, gjë e cila, edhe pse shkurtimisht, thuhet edhe në suren Kurejsh. Fryti më i madh shpirtëror ishte pikërisht Profeti Muhammed, i Dërguari i Allahut<sup>saws</sup>. Pra, ai ishte fjala e pastër që do të shëmbëllet me pemën e



pastër për t'i siguruar njerëzimit frutat qiellore.

Në fund të kësaj sureje thuhet se mohuesit nuk mund ta mundin Islamin, sado që ata të intrigojnë dhe, edhe sikur malet të shkulen nga vendi i tyre për shkak të intrigave të tyre, ata nuk mund t'i mposhtin të Dërguarit e Zotit.

Surja mbyllet me një deklaratë të fuqishme që toka dhe qielli i mohuesve të Profetit Muhammed<sup>savs</sup> do të zëvendësoheshin pashmangshmërisht me një tokë dhe qiell të ri, gjë që do t'i detyrojë mohuesit të dorëzohen dhe të vijnë tufa-tufa pranë Zotit të Gjithëpushtetshëm dhe Triumfues.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. *Elif.Lam.Ra.* (Unë jam Allahu që shoh.) Një Libër që Ne të kemi zbritur që ti të nxjerrësh njerëzit nga errësirat drejt dritës, me urdhrin e Zotit të tyre, drejt rrugës së të Plotfuqishmit, të Lavdishmit;

الرَّكَانِ كَتَبْنَا أَنْزَلْنَاهُ إِلَيْكَ لِتُخْرِجَ النَّاسَ  
مِنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ بِإِذْنِ رَبِّهِمْ إِلَى  
صِرَاطٍ الْعَزِيزِ الْحَمِيدِ ①

3. të Allahut, e të cilit është gjithçka që është në qiej dhe gjithçka që është në tokë. Mohuesit do të kenë shkatërrim përmes një ndëshkimi të rëndë.

اللَّهُ الَّذِي لَهُ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي  
الْأَرْضِ ۗ وَوَيْلٌ لِلْكَافِرِينَ مِنْ عَذَابٍ  
شَدِيدٍ ①

4. Ata që e duan jetën e kësaj bote karshi *ahiretit*, pengojnë nga rruga e Allahut dhe kërkojnë shtrembësi në të. Pikërisht këta janë në humbje të thellë.

الَّذِينَ يَسْتَحِبُّونَ الْحَيَاةَ الدُّنْيَا عَلَى الْآخِرَةِ  
وَيَصُدُّونَ عَنْ سَبِيلِ اللَّهِ وَيَبْغُونَهَا  
عُوجًا ۗ أُولَٰئِكَ فِي ضَلَالٍ بَعِيدٍ ①

5. Ne nuk kemi dërguar ndonjë të dërguar, përveçse në gjuhën e popullit të tij, që ai t'u sqaronte atyre (çdo gjë). Atëherë, Allahu e cilëson të devijuar kë të dojë dhe udhëzon kë të dojë. Ai është i Plotfuqishmi, i Urti.

وَمَا أَرْسَلْنَا مِنْ رَّسُولٍ إِلَّا بِلِسَانِ قَوْمِهِ  
لِيُبَيِّنَ لَهُمْ ۗ فَيُضِلُّ اللَّهُ مَنْ يَشَاءُ وَيَهْدِي  
مَنْ يَشَاءُ ۗ وَهُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ①

6. Ne dërguam Musain me shenjat Tona (bashkë me porosinë) që: Nxirr popullin tënd nga errësirat drejt dritës dhe kujtojua ditët e Allahut. Sigurisht, në të ka shenja për çdokënd që është shumë durimtar (e) shumë

وَلَقَدْ أَرْسَلْنَا مُوسَىٰ بِآيَاتِنَا أَنْ أَخْرِجْ  
قَوْمَكَ مِنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ ۗ وَذَكَّرَهُمْ  
بِآيَاتِ اللَّهِ ۗ إِنَّ فِي ذَٰلِكَ لَآيَاتٍ لِّكُلِّ

falënderues.<sup>1</sup>

صَبَّارٍ شَكُورٍ ①

7. Kur Musai i tha popullit të tij: Kujtojeni bekimin e Allahut mbi ju, kur Ai ju shpëtoi nga populli i Faraonit. Ata ju jepnin ndëshkimin më të rëndë, vrisnin djemtë tuaj kurse gratë tuaja i mbanin gjallë. Në të keni pasur një sprovë shumë të madhe prej Zotit tuaj.

وَإِذْ قَالَ مُوسَى لِقَوْمِهِ اذْكُرُوا نِعْمَةَ اللَّهِ عَلَيْكُمْ إِذْ أَنْجَاكُمْ مِنْ آلِ فِرْعَوْنَ يَسُومُونَكُمْ سُوءَ الْعَذَابِ وَيُدَّبِحُونَ أَبْنَاءَكُمْ وَيَسْتَحْيُونَ نِسَاءَكُمْ ۗ وَفِي ذِكْرِكُمْ بَلَاءٌ مِنْ رَبِّكُمْ عَظِيمٌ ⑤

8. Dhe kur Zoti juaj njoftoi: Nëse falënderoni, Unë patjetër do t'ju shtoj dhe nëse bëheni mosmirënjohës, ndëshkimi Im do të jetë shumë i rëndë.

وَإِذْ تَأَذَّنَ رَبُّكُمْ لَئِنْ شَكَرْتُمْ لَأَزِيدَنَّكُمْ وَلَئِنْ كَفَرْتُمْ إِنَّ عَذَابِي لَشَدِيدٌ ⑧

9. Dhe Musai tha: Nëse bëheni mosmirënjohës ju dhe të gjithë ata që janë në tokë, sigurisht, Allahu është i Pavarur, i Lavdishëm.

وَقَالَ مُوسَى إِنَّ تَكْفُرًا أَنْتُمْ وَمَنْ فِي الْأَرْضِ جَمِيعًا فَإِنَّ اللَّهَ لَغَنِيٌّ حَمِيدٌ ⑩

10. A nuk ju ka ardhur lajmi i atyre që ishin para jush (pra, lajmi) i popullit të Nuhut, i adëve dhe i themudëve dhe i atyre që (erdhën) më pas?! Ata nuk i di ndokush, përveç Allahut.<sup>2</sup> Të dërguarit e tyre u erdhën me shenjat, atëherë (nga mendjemadhësia) ata i vendosën duart në gojët e veta dhe thanë: “Ne e kemi mohuar atë që na sollët dhe ne jemi në një dyshim shqetësues për atë, drejt së cilës ju na ftoni.”

أَلَمْ يَأْتِكُمْ نَبُؤُا الَّذِينَ مِنْ قَبْلِكُمْ قَوْمٌ نُوحٍ وَعَادٍ وَ ثَمُودٌ ۗ وَالَّذِينَ مِنْ بَعْدِهِمْ ۗ لَا يَعْلَمُهُمْ إِلَّا اللَّهُ ۗ جَاءَتْهُمْ رُسُلُهُمْ بِالْبَيِّنَاتِ فَرَدُّوا أَيْدِيَهُمْ فِي أَفْوَاهِهِمْ وَقَالُوا إِنَّا كَفَرْنَا بِمَا أُرْسِلْتُمْ بِهِ وَإِنَّا لَفِي شَكٍّ مِمَّا تَدْعُونَنَا إِلَيْهِ مُرِيبٍ ⑫

1. Shprehja “ditët e Allahut” nënkupton mirësitë dhe ndëshkimet e Allahut (Taxh el-Arus), pra ditët kur Allahu tregon shenjat e Tij të veçanta.

2. Këto fjalë tregojnë se edhe kombet e tjera përveç pasardhësve të Ibrahimit<sup>as</sup>, patën Profetë, sepse fiset e Adit dhe të Themudit u pasuan nga disa popuj të tjerë të cilët “nuk i di ndokush, përveç Allahut”, kurse Profetët që erdhën në mesin e pasardhësve të Ibrahimit<sup>as</sup>, janë përmendur edhe në Kuran edhe në Bibël.

11. Të dërguarit e tyre thanë: A dyshoni në Allah, Krijuesin e qiejve e të tokës?! Ai ju thërret t'ju falë mëkatet tuaja dhe t'ju lëshojë deri në afatin e caktuar. Ata thanë: “E po ju jeni vetëm njerëz sikur ne! Doni të na pengoni nga ajo që e adhuronin etërit tanë! Atëherë na sillni një argument të qartë!”

12. Të Dërguarit e tyre u thanë: “Ne jemi vetëm njerëz sikur ju, por Allahu i jep mirësi kujt të dojë nga robërit e Tij. Dhe ne nuk kemi fuqi t'ju sjellim ndonjë argument, përveçse me lejen e Allahut. Allahut le t'i mbështeten besimtarët.

13. E çfarë na ndodhi që të mos mbështetemi tek Allahu, kurse Ai na udhëzoi në rrugët tona. Ne patjetër do ta durojmë sflitjen tuaj. Allahut le t'i mbështeten ata që kërkojnë mbështetje.”

14. Ata që mohuan u thanë të Dërguarve të tyre: “Ne përnjëmend do t'ju dëbojmë nga toka jonë ose ju të ktheheni në grupin tonë.” Atëherë Zoti i tyre ua shpalli: Ne përnjëmend do t'i shkatërrojmë keqbërësit,

15. dhe ju do t'ju vendosim në tokë pas tyre. Kjo është për atë që i frikësohet Pozitës Sime dhe (që) i frikësohet paralajmërimit Tim.<sup>3</sup>

قَالَتْ رُسُلُهُمْ أِنِّي اللّٰهُ شَكَ فَاطِرِ  
السَّمٰوٰتِ وَالْاَرْضِ ۙ يَدْعُوْكُمْ لِيُغْفِرَ لَكُمْ  
مِّنْ ذُنُوْبِكُمْ وَيُخْرِجَكُمْ اِلَىٰ اَجَلٍ  
مَّسٰى ۙ قَالُوْا اِنْ اَنْتُمْ اِلَّا بَشَرٌ مِّثْلُنَا  
تُرِيْدُوْنَ اَنْ تَصُدُّوْنَا عَمَّا كَانَ يَعْبُدُ  
اَبَاؤُنَا فَاتُّوْنَا بِسُلْطٰنٍ مُّبِيْنٍ ﴿١١﴾

قَالَتْ لَهُمْ رُسُلُهُمْ اِنْ نَّحْنُ اِلَّا بَشَرٌ  
مِّثْلُكُمْ وَلٰكِنَّ اللّٰهَ يَمُنُّ عَلٰى مَنْ يَّشَاءُ  
مِّنْ عِبَادِهِ ۗ وَمَا كَانَ لَنَا اَنْ نَّاتِيَكُمْ  
بِسُلْطٰنٍ اِلَّا بِاِذْنِ اللّٰهِ ۗ وَعَلَى اللّٰهِ  
فَلْيَتَوَكَّلِ الْمُؤْمِنُوْنَ ﴿١٢﴾

وَمَا لَنَا اِلَّا تَتَوَكَّلَ عَلَى اللّٰهِ وَقَدْ هَدٰنَا  
سُبُلَنَا ۗ وَلَنَصْبِرَنَّ عَلٰى مَا اٰذَيْتُمُوْنَا ۗ وَعَلَى  
اللّٰهِ فَلْيَتَوَكَّلِ الْمُتَوَكِّلُوْنَ ﴿١٣﴾

وَقَالَ الَّذِيْنَ كَفَرُوْا لِرُسُلِهِمْ لَنُخْرِجَنَّكُمْ  
مِّنْ اَرْضِنَاۤ اَوْ لَتَعُوْدُنَّ فِيْ مَلٰٓئِنَاۤ فَآوْحٰى  
اِلَيْهِمْ رَبُّهُمْ لَنُهْلِكَنَّ الظّٰلِمِيْنَ ﴿١٤﴾

وَلَنُسَيِّدَنَّكُمْ الْاَرْضَ مِنۢ بَعْدِهِمْ ۗ ذٰلِكَ  
لِمَنْ خَافَ مَقَامِىَ وَخَافَ وَعِيْدِ ﴿١٥﴾

3. Për të përfaqësuar Zotin e Madhërisë, Kurani ka përdorur përemrin edhe në numrin njëjës edhe në atë shumës. Në shumë gjuhë të botës, përemri dhe folja përdoren edhe në

16. Ata i kërkuan fitore (Allahut), atëherë u shkatërrua çdo armik i dhunshëm.

وَاسْتَفْتَحُوا وَخَابَ كُلُّ جَبَّارٍ عَنِيدٍ ۝١٦

17. Pas kësaj (e pret) xhehenemi, ku ai do të pijë ujë të qelbur.

مَنْ وَرَأَاهُ جَهَنَّمَ وَيُسْقَىٰ مِنْ مَّاءٍ صَدِيدٍ ۝١٧

18. Ai do ta gjerbë atë, nuk do ta gëlltisë dot dhe atij do t'i vijë vdekja nga çdo anë, por ai nuk do të vdesë dot. Pas kësaj, ka edhe një ndëshkim të rëndë.

يَتَجَرَّعُهُ وَلَا يَكَادُ يُسِيغُهُ وَيَأْتِيهِ الْمَوْتُ مِنْ كُلِّ مَكَانٍ وَ مَا هُوَ بِحَمِيٍّ ۝١٨  
وَرَأَاهُ عَذَابٌ غَلِيظٌ ۝١٩

19. Shembulli i atyre që mohuan Zotin e tyre është që veprat e tyre janë si hiri, të cilit, në një ditë të stuhishme, i fryn era e fortë. Ata nuk do të kenë fuqi mbi asgjë që punuan. Kjo pikërisht është humbje e thellë.

مَثَلُ الَّذِينَ كَفَرُوا بِرَبِّهِمْ أَعْمَالُهُمْ كَرَمَادٍ اشْتَدَّتْ بِهِ الرِّيحُ فِي يَوْمٍ عَاصِفٍ ۝١٩  
لَا يَقْدِرُونَ عَلَيْهَا كَسَبُوا عَلَىٰ شَيْءٍ ۝٢٠ ذَٰلِكَ هُوَ الصَّلَٰءُ الْبَعِيدُ ۝٢١

20. A nuk e pe që Allahu krijoi qiejt dhe tokën me vërtetësi?! Nëse do Ai (o njerëz), do t'ju largojë ju dhe do të sjellë një krijesë të re.<sup>4</sup>

أَلَمْ تَرَ أَنَّ اللَّهَ خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ بِالْحَقِّ ۝٢٠ إِنَّ شَيْئًا يُدْهَبُكُمْ وَيَأْتِ بِخَلْقٍ جَدِيدٍ ۝٢١

21. Dhe kjo nuk është aspak e rëndë për Allahun.

وَمَا ذَٰلِكَ عَلَى اللَّهِ بِعَزِيزٍ ۝٢١

shumës për njëjës, për të treguar madhëstinë, nderin, fuqinë etj.. Edhe në Kuran vërejmë se aty ku shprehet fuqia dhe madhështia e Zotit, është përdorur numri shumës; dhe aty ku theksohet Vetëmjaftueshmëria e Tij, Pavarësia e Tij, Njëshmëria e Tij etj., është përdorur numri njëjës. Përveç kësaj, disa komentues pohojnë se kur Zoti përmend Vetën e Tij në shumës, përfshin edhe engjëjt, për të nënkuptuar që e gjithë “ushtria” e Tij është vënë në funksion të zbatimit të Vullnetit të Tij. Dhe kur flet në njëjës, nënkupton dekretin e Tij të veçantë. Ky ajet i kombinon të dyja kuptimet.

4. Ky ajet flet për mundësinë që, nëse do Allahu i Madhërishëm, Ai mund ta asgjësojë njerëzimin tërësisht dhe mund ta zëvendësojë atë me një krijesë tjetër të re dhe thotë se kjo nuk është një punë e rëndë për Të.

22. Ata do të dalin bashkërisht përpara Allahut. Atëherë, të dobëtit do t'u thonë mendjemëdhenjve: "Ne ju ndiqnim ju, andaj, a mund të na largoni sadopak ndëshkimitin e Allahut?" Ata do të thonë: "Po të na udhëzonte Allahu, do t'ju udhëzonim edhe ju. Tashmë e kemi njësoj, daç të vajtojmë, daç të durojmë, nuk kemi asnjë rrugëdalje."

23. Dhe djalli do të thotë kur të ketë përfunduar gjykimi: "Sigurisht, Allahu ju bëri premtimin e vërtetë dhe, edhe unë ju premtova, por e shkela premtimin; unë nuk kam pasur asnjë sundim mbi ju, përveçse ju kam thirrur dhe ju m'u përgjigjët. Prandaj, mos më qortoni mua por qortoni veten tuaj. As unë nuk mund t'ju vij dot në ndihmë dhe as ju nuk mund të më vini dot në ndihmë. Unë e mohoj atë që më shoqëronit me Allahun deri më parë. Pikërisht për të padrejtët është ndëshkim i dhimbshëm."

24. Dhe ata që besuan dhe bënë të mira do (t'u mundësohet) të hyjnë në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Në to do të jetojnë përgjithmonë me urdhrin e Zotit të tyre. Dhurata e tyre në to do të jetë paqe.

25. A nuk e pe se si Allahu paraqiti shembullin e një fjale të mirë me një pemë të mirë, e cila rrënjën e ka të ngulitur dhe degën e ka në qiell?!

وَبَرَّوْا لِلَّهِ جَمِيعًا فَقَالَ الضُّعَفَاءُ  
لِلَّذِينَ اسْتَكْبَرُوا إِنَّا كُنَّا لَكُمْ تَبَعًا فَهَلْ  
أَنْتُمْ مُعْتَدُونَ عَنَّا مِنْ عَذَابِ اللَّهِ مِنْ  
شَيْءٍ قَالُوا لَوْ هَدَانَا اللَّهُ لَهَدَيْنَاكُمْ  
سَوَاءٌ عَلَيْنَا أَجْرِعْنَا أَمْ صَبَرْنَا مَا لَنَا  
بِغَيْرِ اللَّهِ مِنْ حَاجٍ ۝

وَقَالَ الشَّيْطَانُ لَمَّا قُضِيَ الْأَمْرُ إِنَّ اللَّهَ  
وَعَدَكُمْ وَعَدَ الْحَقُّ وَعَدْتُكُمْ فَأَخْلَفْتُكُمْ  
وَمَا كَانَ لِي عَلَيْكُمْ مِنْ سُلْطَانٍ إِلَّا أَنْ  
دَعَوْتُكُمْ فَاسْتَجَبْتُمْ لِي فَلَا تَلْمُزُونِي  
وَلَوْ مَوَّأَنْفُسَكُمْ مَا أَنَا بِمُصْرِخِكُمْ وَمَا  
أَنْتُمْ بِمُصْرِخِي إِنْ كَفَرْتُمْ بِمَا  
أَشْرَكْتُمُونِ مِنْ قَبْلُ إِنَّ الظَّالِمِينَ لَهُمْ  
عَذَابٌ أَلِيمٌ ۝

وَأَدْخَلَ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ  
جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ  
فِيهَا بِإِذْنِ رَبِّهِمْ طَيِّبَةً فِيهَا سَلَامٌ ۝

أَلَمْ تَرَ كَيْفَ ضَرَبَ اللَّهُ مَثَلًا كَلِمَةً طَيِّبَةً  
كَشَجَرَةٍ طَيِّبَةٍ أَصْلُهَا ثَابِتٌ وَفَرْعُهَا فِي  
السَّمَاءِ ۝

26. Ajo jep frutën e saj në çdo kohë me urdhrin e Zotit të saj. Allahu paraqet shembujt për njerëzit që ata të reflektojnë.<sup>5</sup>

تَوَاتَىٰ أَكْلَهَا كُلِّ حِينٍ بِإِذْنِ رَبِّهَا  
وَيُضْرَبُ اللَّهُ الْأَمْثَالَ لِلنَّاسِ لَعَلَّهُمْ  
يَتَذَكَّرُونَ ﴿١٦﴾

27. Dhe shembulli i një fjale të keqe është si një pemë e keqe, që është shkukur nga toka, (e që) nuk qëndron më.<sup>6</sup>

وَمَثَلُ كَلِمَةٍ خَبِيثَةٍ كَشَجَرَةٍ خَبِيثَةٍ  
اجْتُثَّتْ مِنْ فَوْقِ الْأَرْضِ مَا لَهَا مِنْ  
قَرَارٍ ﴿١٧﴾

28. Allahu u jep qëndrueshmëri atyre që besuan përmes fjalës së qëndrueshme në jetën e kësaj bote dhe në *ahiret*, dhe i devijon të padrejtët. Allahu bën çfarë të dojë.

يُمَيِّتُ اللَّهُ الَّذِينَ آمَنُوا بِالْقَوْلِ الثَّابِتِ فِي  
الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَفِي الْآخِرَةِ وَيُضِلُّ اللَّهُ  
عَنِ الطَّرِيقِ الَّذِينَ يَخْلَعُونَ بِأَلْسِنَتِهِمُ  
الْكَلِمَ الْمُحَرَّمَةَ وَأَخْرَجُوا بِهَا  
الْحَيَاةَ مِنَ الدُّنْيَا وَاللَّهُ يُضِلُّ  
مَنْ يَشَاءُ ﴿١٨﴾

5. Fjala e besimit (*shehadetî*) që është e lirë nga çdo ekstrem, e pastër nga çdo e metë, nga çdo gënjeshtër dhe nga çdo kotësi dhe që është e përsosur nga çdo anë, i shëmbëllen pemës së shëndoshë, që ka rrënjët thellë në tokë dhe degët të përhapura në qiell dhe jep frutat e saj në çdo kohë. Nuk ka asnjë kohë, që degët e saj të mbeten pa fruta. Në këtë përshkrim, Zoti i Madhërishtëm shëmbëlleu fjalën e besimit me një pemë përherë frutdhënëse, duke treguar tri shenja të saj: (1) Rrënjët e saj, që do të thotë kuptimi i besimit, të jetë i vendosur në tokën e zemrës së njeriut. Pra, ndërgjegjja dhe karakteri i tij ta kenë pranuar vërtetësinë dhe realitetin e tij. (2) Degët e asaj fjale të jenë të përhapura në qiell, që do të thotë se besimi të jetë i logjikshëm dhe të përputhet me ligjin qiellor të natyrës, i cili është vepra e Zotit. Me fjalë të tjera, argumentet për vërtetësinë dhe saktësinë e asaj fjale të gjenden në ligjin e natyrës dhe se ato të jenë kaq të larta, sikur të jenë në qiell, të cilat të mos i zërë dot dora e akuzës. (3) Ajo të ketë frutën e saj të denjë për t'u ngrënë dhe për t'u gjendur në çdo kohë. Pra, pasi ajo fjalë të vihet në praktikë, të japë bekimet dhe ndikimet e saj pozitive në çdo kohë, dhe jo të japë rezultatin për një kohë të caktuar dhe të reshtë. Fruta e kësaj peme nënkupton takimin me Allahun, pra, bekimet qiellore që përbëhen nga komunikimi me Zotin, pranimi i lutjeve dhe i veprave, mrekullitë që Zoti i tregon robit të Tij, siç e thotë edhe në 41:31-33.

6. Fjala e papastër i ngjan pemës që është e shkukur nga toka dhe që nuk zë karar asgjekund. Kjo do të thotë se ajo nuk pranohet nga natyra e pastër e njeriut dhe nuk qëndron as sipas argumenteve të logjikshme, as sipas ligjit të natyrës dhe as sipas ndërgjegjes njerëzore. Ajo rri thjesht si një tregim a përrallë. Për botën e *ahiretit*, Kurani i Shenjtë siç i shëmbëllen pemët e pastra të besimit me rrush, shegë dhe fruta të tjera të shijshme dhe tregon se atë ditë ato do t'u përngajnë këtyre frutave, në të njëjtën mënyrë, pemën e ndyrë të mosbesimit në botën e *ahiretit*, e quan *zakkum*, siç thotë: "A është kjo më e mirë si pritje apo pema e *zakkumit*?!" (37:63).

29. A nuk i pe ata që ndërruan bekimin e Allahut me mohimin dhe e çuan popullin e tyre në shtëpinë e shkatërrimit,

30. (pra në) xhehenem?! Ata do të hyjnë në të. Sa qëndrim i keq është ai!

31. Ata i bënë ortakë Allahut, që t'i devijojnë (të tjerët) nga rruga e Tij. Thuaj: Përfitoni! Kthimi juaj do të jetë drejt zjarrit.

32. Thuaju robërve të Mi që besuan, le të falin namazin, dhe nga ajo që Ne ua kemi dhënë, të shpenzojnë fshehtas e haptas, përpara se të vijë dita kur nuk do të ketë më as tregti e as miqësi.

33. Allahu është Ai që krijoi qiejt dhe tokën, zbriti ujë prej qiellit dhe përmes tij nxori shumë fruta si ushqim për ju. Ai ju nënshtroi anijet, që ato të lundrojnë në det me urdhrin e Tij dhe ju nënshtroi lumenjtë.

34. Dhe ju nënshtroi diellin e hënën; që të dy vazhdimisht janë në lëvizje. Dhe Ai ju nënshtroi natën dhe ditën.

35. Dhe ju dha çdo gjë që i keni kërkuar Atij. Nëse numëroni bekimet e Allahut, nuk i llogaritni dot. Sigurisht, njeriu është shumë i padrejtë (dhe) mosmirënjohës.

أَلَمْ تَرَ إِلَى الَّذِينَ بَدَّلُوا نِعْمَتَ اللَّهِ كُفْرًا  
وَآحَلُّوا قَوْمَهُمْ دَارَ الْبُورِ ۗ

جَهَنَّمَ ۚ يَصَلُّونَهَا ۖ وَيُسُّ الْقُرَارَ ۖ

وَجَعَلُوا لِلَّهِ أَنْدَادًا لِّيُضِلُّوا عَنْ سَبِيلِهِ ۖ  
قُلْ تَمَتَّعُوا فَإِن مَّصِيرَكُمْ إِلَى النَّارِ ۖ

قُلْ لِعِبَادِيَ الَّذِينَ آمَنُوا يُقِيمُوا الصَّلَاةَ  
وَيُنْفِقُوا مِمَّا رَزَقْنَاهُمْ سِرًّا وَعَلَانِيَةً مِّمَّنْ  
قَبْلُ أَلِ يَأْتِي يَوْمَ لَا بَيْعَ فِيهِ وَلَا خِلَالَ ۖ

اللَّهُ الَّذِي خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ وَأَنْزَلَ  
مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَأَخْرَجَ بِهِ مِنَ الثَّمَرَاتِ  
رِزْقًا لَّكُمْ ۗ وَسَخَّرَ لَكُمُ الْفُلْكَ لِتَجْرِيَ  
فِي الْبَحْرِ بِأَمْرِهِ ۗ وَسَخَّرَ لَكُمُ الْأَنْهَارَ ۖ

وَسَخَّرَ لَكُمُ الشَّمْسَ وَالْقَمَرَ دَآبِّينَ ۖ  
وَسَخَّرَ لَكُمُ اللَّيْلَ وَالنَّهَارَ ۖ

وَأَتَّكُم مِّن كُلِّ مَا سَأَلْتُمُوهُ ۖ وَإِن تَعَدُّوا  
نِعْمَتَ اللَّهِ لَا تَحْصُوهَا ۗ إِنَّ الْإِنْسَانَ  
لَظَلُومٌ كَفَّارٌ ۖ



36. Dhe (kujtojeni) kur Ibrahim i tha: “O Zoti im! Bëje këtë qytet të paqes dhe mua dhe djemtë e mi na ruaj që të mos adhurojmë idhujt.

وَإِذْ قَالَ إِبْرَاهِيمُ رَبِّ اجْعَلْ هَذَا الْبَلَدَ  
إِمَامًا وَاجْعَلْنِي وَبَنِيَّ أَنْ نَعْبُدَ الْأَصْنَامَ ۝

37. O Zoti im! Ata vërtet kanë devijuar shumicën e njerëzve. Andaj, ai që më ndoqi është prej meje dhe ai që u bë mosbindës ndaj meje, Ti sigurisht që je shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

رَبِّ إِنَّهُمْ أَضَلَلَنَ كَثِيرًا مِّنَ النَّاسِ ۚ  
فَمَنْ تَعَبْنِي فَإِنَّهُ مِنِّي ۚ وَمَنْ عَصَانِي  
فَإِنَّكَ غَفُورٌ رَّحِيمٌ ۝

38. O Zoti ynë! Kam vendosur disa nga fëmijët e mi në një luginë pa bimësi, pranë Shtëpisë Sate të Shenjtë, o Zoti ynë, që ata të falin namazin. Andaj, bëje që zemrat e njerëzve të anojnë nga ata dhe ushqejni me fruta që ata të falënderojnë.<sup>7</sup>

رَبَّنَا إِنِّي أَسْكَنْتُ مِنْ ذُرِّيَّتِي بِوَادٍ غَيْرِ  
ذِي زَرْعٍ عِنْدَ بَيْتِكَ الْمُحَرَّمِ رَبَّنَا  
لِيُقِيمُوا الصَّلَاةَ فَاجْعَلْ أَفْئِدَةً مِنَ النَّاسِ  
تَهْوِي إِلَىٰ إِلِهِمُ وَارْزُقْهُمْ مِنَ الثَّمَرَاتِ  
لَعَلَّهُمْ يَشْكُرُونَ ۝

39. O Zoti ynë! Ti di atë që fshehim dhe atë që shfaqim. Dhe Allahut nuk i fshihet dot asnjë gjë, as në tokë e as në qiell.

رَبَّنَا إِنَّكَ تَعْلَمُ مَا نُخْفِي وَمَا نُعْلِنُ ۚ  
وَمَا يَخْفَىٰ عَلَى اللَّهِ مِنْ شَيْءٍ فِي الْأَرْضِ  
وَلَا فِي السَّمَاءِ ۝

40. Lavdia është e Allahut që më dhuroi, pavarësisht nga pleqëria, Ismailin dhe Is'hakun. Vërtet, Zoti im e dëgjon shumë lutjen.

الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي وَهَبَ لِي عَلَى الْكِبَرِ  
إِسْمَاعِيلَ وَإِسْحَاقَ ۚ إِنَّ رَبِّي لَسَمِيعُ  
الدُّعَاءِ ۝

7. Hazret Ibrahim<sup>as</sup> çoi djalin e tij, Ismail, dhe gruan Haxhere, në shkretëtirën e Arabisë, aty ku sot ndodhet Meka. Në atë kohë nuk kishte asnjë shenjë jete dhe asnjë mjet jetese në këtë vend (Buhari, nr. 3364). Por Zoti kishte projektuar në atë mënyrë që pikërisht ky vend do të bëhej skena e gjithë veprimtarisë së shenjtë të Profetit Muhammed<sup>saws</sup>, dhe të shpalljes së Kuranit të Shenjtë, Ligjit të fundit të Zotit për njerëzimin. Gjithashtu, kjo lutje e Hazret Ibrahimit<sup>as</sup> u bë në një kohë kur asnjë fije bari nuk shihej për shumë kilometra rreth e për qark Mekës. Megjithatë, profecia u përmbush në mënyrë kaq të mrekullueshme, sa që pas vendosjes së fesë Islame, frutat nga e gjithë bota vijnë në Mekë me bollëk, në të gjitha stinët.

41. O Zoti im! Më bëj falës të namazit dhe, edhe pasardhësit e mi! Dhe, o Zoti ynë, prano lutjen time!

رَبِّ اجْعَلْنِي مُقِيمَ الصَّلَاةِ وَمِنْ ذُرِّيَّتِي  
رَبَّنَا وَتَقَبَّلْ دُعَاءِ ﴿٤١﴾

42. O Zoti ynë! Më fal mua, prindërit e mi dhe besimtarët, ditën kur do të bëhet llogari.”

رَبَّنَا اغْفِرْ لِي وَلِوَالِدَيَّ وَلِلْمُؤْمِنِينَ يَوْمَ  
يَقُومُ الْحِسَابُ ﴿٤٢﴾

43. Asnjëherë mos e mendo Allahun të pavëmendshëm ndaj asaj që bëjnë keqbërësit. Në të vërtetë, Ai u jep lëshim deri në ditën kur do të shtangen sytë.

وَلَا تَحْسَبَنَّ اللَّهَ غَافِلًا عَمَّا يَعْمَلُ  
الظَّالِمُونَ ۗ إِنَّمَا يُؤَخِّرُهُمْ لِيَوْمٍ تَشْخَصُ  
فِيهِ الْأَبْصَارُ ﴿٤٣﴾

44. Ata do të vërtiten me kokën përperjetë; nuk do t’u kthehet shikimi (pra, nuk mund të shohin dot) dhe do t’u zbrazen zemrat!

مُهْطِعِينَ مُقْنِعِي رُءُوسِهِمْ لَا يَرْتَدُّ  
إِلَيْهِمْ طَرْفُهُمْ ۗ وَأَفِئْتُهُمْ هَوَآءٍ ﴿٤٤﴾

45. Alarmo njerëzit nga dita kur do t’u vijë ndëshkimi, atëherë ata që bënë keq, do të thonë: “O Zoti ynë! Na lësho për një afat të vogël, do ta pranojmë thirrjen Tënde dhe do t’i ndjekim të Dërguarit!” “A nuk bënit be deri më parë që për ju nuk do të ketë rënie?!

وَأَنْذِرِ النَّاسَ يَوْمَ يَأْتِيهِمُ الْعَذَابُ فَيَقُولُ  
الَّذِينَ ظَلَمُوا رَبَّنَا أَخِّرْنَا إِلَىٰ أَجَلٍ  
قَرِيبٍ ۗ لَنُجِبَ دَعْوَتَكَ وَنَتَّبِعَ الرَّسُولَ  
أَوْلَمَ تَكُونُوا أَقْسَمْتُمْ مِّنْ قَبْلِ  
مَا لَكُمْ مِنْ زَوَالٍ ﴿٤٥﴾

46. Dhe ju banonit në shtëpitë e atyre që i bënë keq vetvetes, ju ishte bërë e qartë se çfarë bëmë Ne me ta dhe ju paraqitëm (edhe) shembujt.”

وَسَكَنْتُمْ فِي مَسْكِنِ الَّذِينَ ظَلَمُوا  
أَنْفُسَهُمْ وَتَبَيَّنَ لَكُمْ كَيْفَ فَعَلْنَا بِهِمْ  
وَصَرَبْنَا لَكُمْ الْأَمْثَالَ ﴿٤٦﴾

47. Sigurisht, ata e thurën intrigën e tyre dhe tek Allahu është intriga e tyre; edhe sikur intriga e tyre të lëvizte malet.

وَقَدْ مَكَرُوا مَكْرَهُمْ وَعِنْدَ اللَّهِ  
مَكْرُهُمْ ۗ وَإِنْ كَانَ مَكْرُهُمْ لِتَزُولَ  
مِنْهُ الْجِبَالُ ﴿٤٧﴾

48. Prandaj, kurrresi mos e mendo Allahun shkelës të premtimit të Tij ndaj të Dërguarve të Vet. Pa dyshim, Allahu është i Plotfuqishëm, Hakmarrës.

فَلَا تَحْسَبَنَّ اللَّهَ مُخْلِفَ وَعْدِهِ رُسُلَهُ ۗ إِنَّ اللَّهَ عَزِيزٌ ذُو انْتِقَامٍ ﴿٤٨﴾

49. Ditën kur toka do të ndryshojë me tokën tjetër dhe, edhe qiejt do të dalin para Allahut, të Vetmit, Triumfuesit.

يَوْمَ نُبَدِّلُ الْأَرْضَ غَيْرَ الْأَرْضِ وَالسَّمَوَاتِ وَبَرَزُوا لِلَّهِ الْوَاحِدِ الْقَهَّارِ ﴿٤٩﴾

50. Atë ditë do të shohësh fajtorët të prangosur nëpër zinxhirë.

وَتَرَى الْمُجْرِمِينَ يَوْمَئِذٍ مُّقْرَّنِينَ فِي الْأَصْفَادِ ﴿٥٠﴾

51. Petku i tyre do të jetë prej katrani dhe fytyrat e tyre do t'i mbulojë zjarri,

سَرَابِيبُهُمْ مِّنْ قَطْرَانٍ وَتَعْشَىٰ وُجُوهُهُمْ النَّارُ ﴿٥١﴾

52. që Allahu t'i kthejë çdo shpirti atë që ka punuar ai. Sigurisht, Allahu është i shpejtë në llogari.

لِيَجْزِيَ اللَّهُ كُلَّ نَفْسٍ مَّا كَسَبَتْ ۗ إِنَّ اللَّهَ سَرِيعُ الْحِسَابِ ﴿٥٢﴾

53. Ky është një mesazh për njerëzit, që ata të paralajmërohen prej tij, ta dinë se vetëm Ai është i Adhurueshmi i Vetëm dhe të mendohen të mençurit.

هَذَا بَلَاغٌ لِلنَّاسِ وَلِيُنذَرُوا بِهِ وَلِيَعْلَمُوا أَنَّمَا هُوَ إِلَهٌ وَاحِدٌ وَلِيَذْكُرُوا أولُوا  
الْأَنْبَاءِ ﴿٥٣﴾

## Surja 15 – El-Hixhr

Surja El-Hixhr është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka njëqind ajete.

Kjo sure fillon me shkurtesat *Elif.lam.ra* dhe pas kësaj sureje, ato nuk përsëriten.

Shenjat e madhështisë dhe të bukurisë së Allahut që janë përmendur në suren paraardhëse ndikojnë edhe në zemrat e mohuesve. Në këtë sure thuhet se ky ndikim është aq i fuqishëm, saqë edhe ata nganjëherë shprehen në zemër: “Sikur të besonim edhe ne!” Por sërish kthehen në gjendjen e tyre. Ata nuk mund ta mohojnë fitoren e të Dërguarve, por i akuzojnë të Dërguarit se u kanë bërë magji syve të tyre.

Allahu i Madhërishëm trumbeton fuqishëm: Le të thotë çfarë të dojë armiku, Ne e kemi zbritur këtë Libër dhe Ne Vetë do ta mbrojmë atë.

Në ajetet vijuese përmendet fjala “el-buruxh” (*yjësité*) që na kujton suren 85, e cila gjithashtu quhet “El-Buruxh”. Kjo tregon se premtimi “Ne Vetë do ta mbrojmë atë” nuk përfshin vetëm tekstin e Kuranit, por gjithmonë do të caktohen njerëz që do të jenë shërbëtorë të Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, të cilët do ta ruajnë atë edhe kuptimisht. Po kështu, fjala “buruxh” na kumton që të njëjtin synim kanë pasur edhe reformatorët që erdhën si dymbëdhjetë *yjësi*, pas Profetit Muhammed<sup>savs</sup>.

Ashtu siç nuk sosen kuptimet e Kuranit të Shenjtë, në të njëjtën mënyrë, Zoti i Madhërishëm do t’i mundësojë njerëzimit herë pas here thesare të pashtershme edhe në botën lëndore. Një shembull i kësaj është sistemi i lëndës djegëse. Dikur njeriu frikësohej se çfarë do të bënte nëse përfundonte druri. Dhe në një kohë tjetër kishte frikë nga sosja e qymyrit. Erdhi një kohë kur njeriu u shqetësua se çfarë do të bënte nëse do të mbaronte nafta. Por pa mbaruar nafta akoma, Zoti i Madhërishëm ia kthehu vëmendjen te një burim tjetër i fuqisë së pashtershme, pra, fuqia bërthamore. Nëse njeriu do të bëhet i aftë të përfitojë siç duhet nga kjo fuqi, duke marrë masat edhe për të shpëtuar nga pasojat e saj, kjo është një fuqi që ndoshta nuk do të shterohet as deri në fund të botës. Kështu që, ashtu siç thesaret shpirtërore të Kuranit nuk sosen, nuk sosen edhe thesaret fizike që janë të nevojshme për mbijetesën e njeriut.

Pas kësaj thuhet se këto dy lloje thesaresh që Zoti i Madhërishëm do të vijojë t’i dërgojë, do të bëjnë që edhe djalli të intrigojë me pëshpëritjet e tij dhe këto pëshpëritje, gjithashtu, nuk do të mbarojnë deri në Ditën e Kiametit.

Pas kësaj flitet për *Hazret Ibrahim*<sup>as</sup>, për profetë të tjerë dhe për popujt e tyre. Në vazhdë të kësaj teme, si shembuj përmenden popujt *as-habul-ejkeh* dhe *as-habul-hixhr*, gjë që tregon se edhe në të ardhmen, Zoti i Madhërishëm kështu do të shkatërrojë kundërshtarët e të Dërguarve të Tij.

Kjo sure flet edhe për lajmin e mirë që i ishte dhënë *Hazret Ibrahim*<sup>as</sup> për lindjen e një djali. Në këtë kontekst përmenden edhe *Hazret Is’haku*<sup>as</sup>, *Hazret Jakubi*<sup>as</sup> etj., megjithatë, profecia më së pari përmbushet në personin e *Hazret Ismailit*<sup>as</sup>, ndër

pasardhësit e të cilit do të ishte edhe *Hazret Profeti Muhammed<sup>savs</sup>*, si biologjikisht, ashtu edhe shpirtërisht.

Kjo sure i jep qetësi Profetit Muhammed<sup>savs</sup> se Zoti i Madhërishëm Vetë do të merrej me ata që e përqeshnin, prandaj, Ai e porositi: Toleroji! Dhe kurdo që fjalët e tyre të të lëndojnë zemrën, duro dhe lavdëro Zotin tënd!



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. *Elif.Lam.Ra.* (Unë jam Allahu që shoh.)<sup>1</sup> Këto janë ajetet e Librit dhe të një Kurani të qartë.

الرَّحْمٰنُ تِلْكَ اٰیٰتُ الْكِتٰبِ وَقُرْٰنٍ مُّبِيْنٍ ①

Xhuzi 14

3. Ata që mohuan, nganjëherë dëshirojnë të ishin muslimanë.

لَئِيْۤنْ رُبَّمَا يَوَدُّ الَّذِيْنَ كَفَرُوْا لَوْ كَانُوْا مُسْلِمِيْنَ ②

4. Lëri (në gjendjen e tyre), të hanë, të përfitojnë dhe t'i mashtrojë shpresa. Së shpejti do të mësojnë.

ذُرِّهٖمْ يَأْكُلُوْا وَيَمْتَعُوْا وَيُلٰهِيْهِمُ الْاٰمَلُ فَسَوْفَ يَعْلَمُوْنَ ③

5. Ne nuk kemi shkatërruar ndonjë vendbanim, para se ai të ketë pasur një Libër të njohur.

وَمَا اَهْلَكْنَا مِنْ قَرْيَةٍ اِلَّا وَلَهَا كِتٰبٌ مَّعْلُوْمٌ ④

6. Asnjë popull nuk e parakalon dot afatin e vet dhe as nuk mund të vonohet.

مَا تَسْبِقُ مِنْ اُمَّةٍ اَجَلَهَا وَمَا يَسْتَاخِرُوْنَ ⑤

7. Dhe thanë: “O ti që të zbriti këshilla, vërtet je i çmendur!

وَقَالُوْا يَآٰئِيْهَا الَّذِيْ نَزَّلَ عَلَيْهِ الذِّكْرُ اِنَّكَ لَمَجْنُوْنٌ ⑥

8. Pse nuk na sjell engjëjt, nëse thua të vërtetën?”

لَوْ مَا تَاتَيْنَا بِالْمَلٰٓئِكَةِ اِنْ كُنْتَ مِنَ الصّٰدِقِيْنَ ⑦

9. Ne nuk zbresim engjëjt, përveçse me të vërtetën dhe atëherë atyre nuk do t'u jepet kohë.

مَا نُنزِلُ الْمَلٰٓئِكَةَ اِلَّا بِالْحَقِّ وَمَا كَانُوْا اِذَا مُنظَرِيْنَ ⑧

1. Për shkurtesat, lexoni 2:2 dhe 7:2.

10. Sigurisht, Ne e zbritëm këtë Këshillë dhe sigurisht, Ne do ta mbrojmë atë.<sup>2</sup>

إِنَّا نَحْنُ نَزَّلْنَا الذِّكْرَ وَإِنَّا لَهُ لَحَافِظُونَ ﴿١٠﴾

11. Edhe para teje kemi dërguar (të dërguar) në grupet e para.

وَلَقَدْ أَرْسَلْنَا مِنْ قَبْلِكَ فِي شِعَعِ الْأَوَّلِينَ ﴿١١﴾

12. Dhe sa herë që u vinte ndonjë i dërguar, ata vetëm talleshin me të.

وَمَا يَأْتِيهِمْ مِنْ رَسُولٍ إِلَّا كَانُوا بِهِ يَسْتَهْزِئُونَ ﴿١٢﴾

13. Ne kështu ua fusim këtë (mosbindje) në zemra keqbërësve.

كَذَلِكَ نَسْلُكُهُ فِي قُلُوبِ الْمُجْرِمِينَ ﴿١٣﴾

14. Ata nuk e besojnë këtë (të Dërguar); dhe sigurisht, ka kaluar

لَا يُؤْمِنُونَ بِهِ وَقَدْ خَلَتْ سُنَّةٌ

2. Premtimi për mbrojtjen dhe ruajtjen e Kuranit, i bërë në këtë ajet, është përmbushur në mënyrë të jashtëzakonshme, saqë edhe sikur të mos kishte asnjë provë tjetër, vetëm ky fakt do të mjaftonte për të vërtetuar origjinën e tij Hyjnore. Kjo sure u shpall në Mekë, kur jeta e Profetit të Shenjtë dhe e pasuesve të tij ishte tepër e pasigurt dhe armiku lehtësisht mund ta shtypte dhe ta asgjësonte fenë Islame. Në një kohë të tillë, Kurani i sfidon mohuesit të bënin më të keqen për ta shkatërruar atë dhe i paralajmëron se Zoti do t'ua prishte të gjitha planet, sepse Ai Vetë ishte Mbrojtësi i tij. Sfida ishte e hapur dhe e qartë, kurse armiku i fortë dhe i pamëshirshëm, e megjithatë Kurani mbeti i sigurt jo vetëm nga asgjësimi, por edhe nga dëmtimi më i vogël që mund t'ia zbehte sadopak autenticitetin e tij. Madje, duke mbetur njësoj edhe sot e gjithë ditën, ky Libër Hyjnor çdo ditë po vulos vërtetësinë e premtimeve që përmendet në këtë ajet. Ky është ekskluziviteti vetëm i Kuranit të Shenjtë ndër të gjithë Librat e tjerë të shpallur. Sir William Muir, kritik i famshëm, i armiqësuar me Islamin, për autenticitetin e Kuranit detyrohet të pohojë: "... ne kemi çdo siguri, qoftë të brendshme apo të jashtme, se teksti që posedojmë ne, është i njëjti që Muhammedi vetë kishte parashtruar dhe përdorur..." "Të krahasosh tekstin e tyre të pastër me leximet e ndryshme të Shkrimeve tona, do të thotë të krahasosh gjëra mes të cilave nuk ka analogji." (William Muir, "The Life of Mohammad", Edinburgh, 1923, fq. xxiii.) Orientalisti i famshëm gjerman, Theodor Nöldeke shkruan: "Të gjitha përpjekjet e studiuesve evropianë për të provuar praninë e ndërhyrjeve të mëvonshme në Kuran, kanë dështuar." (Enc. Brit. botimi XI, vëll. XV, zëri: Koran, autorë: Theodor Nöldeke & Friedrich Schwally, Nju Jork 1911, fq. 905.) Po kështu, kjo mbrojtje e Kuranit nuk është vetëm e tekstit, por edhe e kuptimit të tij. Pas Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, Kalifët e tij të Drejtë<sup>ra</sup> ishin mjete Hyjnore për mbrojtjen kuptimore të Kuranit. Më pas, sipas profecisë së Profetit<sup>savs</sup>, në krye të çdo shekulli, muslimanët patën ndonjë reformator (*muxheddid*), i cili e bëri detyrën e mbrojtjes kuptimore të Kuranit (Ebu Davud, nr. 4291). Dhe në këtë kohë, kur muslimanët e gëzojnë tekstuallisht të njëjtin Kuran, por janë të përçarë për kuptimet e tij (Mishkat, nr. 276), po sipas profecisë së Profetit<sup>savs</sup>, Imam Mehdiu<sup>as</sup> dhe Xhemati i tij do ta bënë detyrën e mbrojtjes kuptimore të Kuranit të Shenjtë (Musned Ahmed, nr. 9323). Lexoni edhe 75:17-18.

edhe praktika e të parëve.

الْأُولَئِينَ ﴿١٥﴾

15. Po t'u kishim çelur ndonjë derë prej qiellit, do të fillonin të ngjiteshin në të (për të parë me sy vërtetësinë e të Dërguarit).

وَلَوْ فَتَحْنَا عَلَيْهِمْ بَابًا مِّنَ السَّمَاءِ فَظَلُّوا فِيهِ يَعْرُجُونَ ﴿١٥﴾

16. (Edhe atëherë patjetër) do të thoshin: “Na janë dehur sytë, madje ne u bëmë njerëz të magjepsur!”

لَقَالُوا إِنَّمَا سُكِّرَتْ أَبْصَارُنَا بَلْ نَحْنُ قَوْمٌ مَّسْحُورُونَ ﴿١٦﴾

17. Sigurisht, në qiell bëmë (disa) yjësi dhe atë e zbukuruam për ata që shohin.

وَلَقَدْ جَعَلْنَا فِي السَّمَاءِ بُرُوجًا وَرَآئِهَا لِلظَّالِمِينَ ﴿١٧﴾

18. Po ashtu, e mbrojtëm atë nga çdo djall i përzënë.

وَحَفِظْنَاهَا مِنْ كُلِّ شَيْطَانٍ رَّجِيمٍ ﴿١٨﴾

19. Përveç atij që vjedh ndonjë dëgjesë, atëherë atë e ndjek një flakë e ndezur.

إِلَّا مَنِ اسْتَرَقَ السَّمْعَ فَاتَّبَعَهُ شَهَابٌ مُّبِينٌ ﴿١٩﴾

20. Dhe tokën e shtruam, në të cilën vumë (male) të ngulitura fort dhe në të mbollëm çdo gjë të përshtatshme.

وَالْأَرْضَ مَدَدْنَاهَا وَأَلْقَيْنَا فِيهَا رَوَاسِيَ وَأَوْبُنَّا فِيهَا مِنْ كُلِّ شَيْءٍ مَّوْرُودٍ ﴿٢٠﴾

21. Në të krijuam mjetet e jetesës edhe për ju, edhe për atë që ju nuk jeni ushqyes.

وَجَعَلْنَا لَكُمْ فِيهَا مَعَايِشَ وَمَنْ لَسْتُمْ لَهُ بِرِزْقَيْنَ ﴿٢١﴾

22. Dhe për çdo gjë Ne kemi thesaret e saj dhe Ne nuk e zbresim atë, përveçse në një sasi të përcaktuar.<sup>3</sup>

وَإِنْ مِنْ شَيْءٍ إِلَّا عِنْدَنَا خَزَائِنُهُ وَمَا نُنزِلُ إِلَّا بِالْقَدَرِ مَعْلُومٍ ﴿٢٢﴾

3. Thesaret e Zotit janë të pafundme, por në saje të mëshirës së Tij të pakufishme, Ai i tërheq vëmendjen njeriut për diçka të caktuar, kur ajo bëhet e nevojshme për njeriun. Kjo jo vetëm në botën lëndore, por edhe në botën shpirtërore. Kurani është universi i botës shpirtërore, dhe si i tillë, Zoti u zbulon thesaret e tij njerëzve të zgjedhur sipas nevojës së njerëzimit. Lexoni edhe 56:80.



23. Dhe dërguam erërat e ngarkuara (me ujë), zbritëm ujë prej qiellit dhe jua sollëm për të pirë. Ju nuk mund ta rezervonit atë.

وَأَرْسَلْنَا الرِّيحَ لَوَاقِحَ فَأَنْزَلْنَا مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَأَسْقَيْنَاكُمُوهُ ۗ وَمَا أَنْتُمْ لَهُ بِخَازِنِينَ ﴿٢٣﴾

24. Dhe jemi Ne që japim jetë dhe shkaktojmë vdekjen dhe po Ne jemi Trashëgues.

وَأِنَّا لَنَحْنُ نُحْيِي وَنُمِيتُ وَنَحْنُ الْوَارِثُونَ ﴿٢٤﴾

25. Njëmend, Ne i dimë edhe parakaluesit prej jush dhe gjithashtu i dimë edhe të mbeturit pas.

وَلَقَدْ عَلِمْنَا الْمُسْتَقْدِمِينَ مِنْكُمْ وَلَقَدْ عَلِمْنَا الْمُسْتَأْخِرِينَ ﴿٢٥﴾

26. Dhe Zoti yt patjetër do t'i mbledhë ata. Pa dyshim, Ai është i Urtë, i Gjithëdijshëm.

وَإِنَّ رَبَّكَ هُوَ يَحْشُرُهُمْ ۗ إِنَّهُ حَكِيمٌ عَلِيمٌ ﴿٢٦﴾

27. Vërtet, Ne krijuam njeriun prej një balte të thatë kumbuese, prej baltës së tharmuar.

وَلَقَدْ خَلَقْنَا الْإِنْسَانَ مِنْ صَلْصَالٍ مِّنْ حَمَإٍ مَّسْنُونٍ ﴿٢٧﴾

28. Dhe xhindët i krijuam më parë prej afshit të zjarrit.

وَأَنجَانٍ خَلَقْنَاهُ مِنْ قَبْلُ مِنْ نَّارِ السَّمُومِ ﴿٢٨﴾

29. Dhe kur Zoti yt u tha engjëjve: Njëmend, Unë do të krijoj një njeri prej një balte të thatë kumbuese, prej baltës së tharmuar.<sup>4</sup>

وَإِذْ قَالَ رَبُّكَ لِلْمَلٰٓئِكَةِ إِنِّي خَالِقٌ بَشَرًا مِّنْ صَلْصَالٍ مِّنْ حَمَإٍ مَّسْنُونٍ ﴿٢٩﴾

4. Në këto ajete (27-30), dy gjëra na kërkojnë vëmendje. Së pari, Zoti nuk e krijoi njeriun vetëm nga dheu i lagur, por nga një dhe që ishte “i kalbur”, i cili më vonë ishte shndërruar në baltë kumbuese, sikur poçe. Kjo është temë që Profeti Muhammed<sup>savs</sup> në asnjë mënyrë nuk mund ta sajonte vetë dhe asnjë Libër tjetër qiellor para Kuranit nuk e përmend krijimin e njeriut prej balte të thatë kumbuese. Por pikërisht këtë e kanë zbuluar shkencëtarët në kohët tona. Së dyti, përpara se të krijohej njeriu, u krijuan “xhinn” prej një ere shumë të nxehtë sikur zjarri, që binte nga qielli. Edhe kjo është një çështje që Profeti Muhammed<sup>savs</sup> vetë nuk mund ta imagjinonte dot, derisa nuk do të njoftohej prej Zotit të Dijshmit të së padukshmes. “Xhinnët” (xhindët, pra, krijesat e padukshme) e krijuar nga afshi i zjarrit janë bakteret e para. Kjo e zgjidh edhe enigmën se si mund të kalbej balta kur nuk kishte jetë përpara krijimit të njeriut. Në fakt ishin bakteret që e bën dheun e njomë të fermentohej, pra të ndryshohej në përmbajtjen e tij. Për më shumë rreth xhindëve, lexoni 6:129.

30. Kur ta plotësoj atë dhe të fryj në të prej Shpirtit Tim, bini në sexhde për të (për t'iu nënshtruar atij).<sup>5</sup>

فَإِذَا سَوَّيْتَهُ وَنَفَخْتَ فِيهِ مِنْ رُوحِي  
فَقَعُوا لَهُ سَاجِدِينَ ﴿٣٠﴾

31. Atëherë engjëjt bënë sexhde, që të gjithë.

فَسَجَدَ الْمَلَائِكَةُ كُلُّهُمْ أَجْمَعُونَ ﴿٣١﴾

32. Përveç djallit (pra, *Iblisit*). Ai mohoi të ishte bashkë me ata që bënë sexhde.

إِلَّا إِبْلِيسَ ۖ أَبَىٰ أَنْ يَكُونَ مَعَ  
السَّاجِدِينَ ﴿٣٢﴾

33. (Zoti) tha: “O *Iblis*! Çfarë ke që nuk bëhesh bashkë me ata që bënë sexhde?”

قَالَ يَا بَلِيسَ مَا لَكَ إِلَّا تَكُونَ مَعَ  
السَّاجِدِينَ ﴿٣٣﴾

34. (Djalli) tha: “Nuk jam i tillë që të bëj sexhde për një njeri që e krijove prej një balte të thatë kumbuese, prej baltës së tharmuar.”

قَالَ لَمْ أَكُنْ لِأَسْجُدَ لِبَشَرٍ خَلَقْتَهُ  
مِنْ صَلْصَالٍ مِنْ حَمَإٍ مَسْنُونٍ ﴿٣٤﴾

35. (Zoti) tha: “Dil nga ky (vend), sepse ti je i përzënë.

قَالَ فَاخْرُجْ مِنْهَا فَإِنَّكَ رَجِيمٌ ﴿٣٥﴾

36. Dhe do të kesh mbi vete mallkimin deri në Ditën e Gjykimit.”

وَإِنَّ عَلَيْكَ اللَّعْنَةَ إِلَىٰ يَوْمِ الدِّينِ ﴿٣٦﴾

37. Ai tha: “O Zoti im! Më jep afat deri në ditën kur do të ngrihen (njerëzit).”

قَالَ رَبِّ فَأَنْظِرْنِي إِلَىٰ يَوْمٍ يُبْعَثُونَ ﴿٣٧﴾

38. (Zoti) tha: “Ti je nga ata që u kemi dhënë afat.

قَالَ فَإِنَّكَ مِنَ الْمُنْظَرِينَ ﴿٣٨﴾

5. Përveç këndvështrimit shkencor, këto ajete hedhin dritë edhe mbi botën shpirtërore. Zoti me Urtësinë e Tij e krijoi Ademin në atë mënyrë që, në natyrën e tij vuri dy lidhje, njëren me Vetë Zotin, siç e pohon ky ajet, duke fryrë në të diçka prej Shpirtit të Tij. Kjo u bë në mënyrë që njeriu në natyrën e tij të ketë lidhje me Zotin. Nga ana tjetër, ishte e nevojshme të krijohej një lidhje e natyrshme edhe mes Ademit dhe atyre që do të quheshin njerëz. Përderisa ata do të kishin eshtra nga eshtrat e Ademit dhe mish nga mishi i Ademit, domosdoshmërisht do të merrnin pjesë në Shpirtin që u fry në të. Më shumë për Ademin, lexoni 2:31 dhe 7:12.

39. Deri në ditën e kohës së përcaktuar.”

إِلَى يَوْمِ الْوَقْتِ الْمَعْلُومِ ﴿٣٩﴾

40. (Djali) tha: “O Zoti im! Tani që më cilësove të devijuar, patjetër do t’ua zbukuroj atyre (qëndrimin) në tokë dhe do t’i devijoj të gjithë ata;

قَالَ رَبِّ بِمَا أَغْوَيْتَنِي لَأُزَيِّنَنَّ لَهُمْ فِي الْأَرْضِ وَلَا أُغْوِيَنَّهُمْ أَجْمَعِينَ ﴿٤٠﴾

41. përveç robërve të Tu të zgjedhur prej tyre.”

إِلَّا عِبَادَكَ مِنْهُمُ الْمُخْلَصِينَ ﴿٤١﴾

42. (Zoti) tha: “E kam Unë përsipër (të udhëzoj në) këtë rrugë të drejtë.

قَالَ هَذَا صِرَاطٌ عَلَيَّ مُسْتَقِيمٌ ﴿٤٢﴾

43. Pa dyshim, ti nuk do të kesh sundim mbi robërit e Mi,<sup>6</sup> përveç të devijuarve që do të të ndjekin ty.

إِنَّ عِبَادِي لَيْسَ لَكَ عَلَيْهِمْ سُلْطَانٌ إِلَّا مَنِ اتَّبَعَكَ مِنَ الْغَاوِينَ ﴿٤٣﴾

44. Dhe pa dyshim, vendi i premtuar i atyre të gjithëve do të jetë xhehenemi.”

وَأَنَّ جَهَنَّمَ لَمَوْعِدُهُمْ أَجْمَعِينَ ﴿٤٤﴾

45. Ai ka shtatë porta; për çdo portë ka një pjesë të përcaktuar të atyre (të devijuarve).<sup>7</sup>

لَهَا سَبْعَةُ أَبْوَابٍ لِكُلِّ بَابٍ مِنْهُمْ جُزْءٌ مَّقْسُومٌ ﴿٤٥﴾

46. Sigurisht, të druajturit (ndaj Zotit) do të jenë mes kopshtesh e burimesh.

إِنَّ الْمُتَّقِينَ فِي جَنَّاتٍ وَعُيُونٍ ﴿٤٦﴾

6. Se në ç’kuptim të jetë njeriu rob i Zotit, lexoni 1:6.

7. Xhehenemi ka shtatë porta, një kuptim i kësaj është që shtatë janë burimet kryesore të mëkatit. Për shembull, njëri prej tyre është paragjykimi. Paragjykimi e shkatërron njeriun. Realisht, të gjithë adhuruesit e gënjeshtres përfundojnë në këtë gjendje për shkak se e paragjykojnë të vërtetën. Burimi tjetër i mëkatit është mendjemadhësia. Mendjemadhi rri i mënjanuar nga e vërteta, andaj Zoti nuk ia mundëson të besojë, siç besojnë fatbardhët. Burimi tjetër i mëkatit është injoranca, e cila gjithashtu e shkatërron njeriun. Një tjetër burim është ndjekja e tundimeve ose e dëshirave të ulta. Po kështu, një burim tjetër i mëkatit është imitimi i pamenduar i të parëve. Kështu mëkati ka shtatë porta dhe që të gjitha Kurani i Shenjtë i shpjegon me detaje e me shembuj.

47. “Hyni në to me siguri (dhe) paqe!”<sup>8</sup>

أَدْخُلُوهَا بِسَلَامٍ آمِنِينَ ﴿٤٧﴾

48. Ne do t’ua heqim çfarëdo urrejtje (qoftë) në kraharorët e tyre. Do të jenë të ulur si vëllezër përballë njëritjetrit në divane.<sup>9</sup>

وَنَزَعْنَا مَا فِي صُدُورِهِمْ مِّنْ غَلٍ إِخْوَانًا  
عَلَىٰ سُرُرٍ مُّتَقِيلِينَ ﴿٤٨﴾

49. Në to nuk do t’i prekë ata as lodhja dhe as nuk do të dëbohen prej tyre.

لَا يَمَسُّهُمْ فِيهَا نَصَبٌ وَ مَا هُمْ مِنْهَا  
بِمُخْرَجِينَ ﴿٤٩﴾

50. Njoftoji robërit e Mi që pikërisht Unë jam Falësi, Mëshirëbërësi,

نَبِيٌّ عَبْدِي أَيُّ أَنَا الْعَفْوَورُ الرَّحِيمُ ﴿٥٠﴾

51. dhe pikërisht ndëshkimi Im është ndëshkimi i dhimbshëm.

وَأَنَّ عَذَابِي هُوَ الْعَذَابُ الْأَلِيمُ ﴿٥١﴾

52. Njoftoji ata edhe për mysafirët e Ibrahimit.

وَنَبِّئُهُمْ عَنِ صَيْفِ إِبْرَاهِيمَ ﴿٥٢﴾

53. Kur ata hyjnë tek ai, thanë: “Paqe!” Ai tha: “Jemi të frikësuar prej jush.”

إِذْ دَخَلُوا عَلَيْهِ فَقَالُوا سَلَامًا قَالَ إِنَّا  
مِنْكُمْ وَجُلُودٌ ﴿٥٣﴾

54. Ata thanë: “Mos u frikëso! Në të vërtetë, ne po të japim lajmin e mirë të një djali të dijshtëm.”

قَالُوا لَا تَوْجَلْ إِنَّا نُبَشِّرُكَ بِغُلَامٍ  
عَلِيمٍ ﴿٥٤﴾

55. Ai tha: “Mua më dhatë lajmin e mirë pavarësisht se më ka prekur pleqëria?! Mbi ç’bazë po më jepni lajmin e mirë?”

قَالَ أَبَشَّرْتُمُونِي عَلَىٰ أَنْ مَسَّنِيَ الْكِبَرُ  
فِيمَا تَبَشَّرُونَ ﴿٥٥﴾

8. Fjalët “siguri” dhe “paqe” nënkuptojnë çlirimin si nga ankthet e brendshme që ta hanë shpirtin, ashtu edhe nga dhimbja apo ndëshkimi që të vjen nga jashtë.

9. Me fjalë të tjera, Kurani i Shenjtë pohon se xhenetin e shijojnë ata, të cilët nuk ushqejnë urrejtje në zemrat e tyre. Vetë gjendja e zemrës së tyre e simbolizon gjendjen e xhenetit që përmendet në këtë ajet.

56. Ata thanë: “Të dhamë lajmin e mirë mbi të vërtetën, andaj, mos u bëj ndër të dëshpëruarit.”

قَالُوا بِشَرِّكَ بِالْحَقِّ فَلَا تَكُنْ مِّنَ  
الْقَاطِبِينَ ﴿٥٦﴾

57. Ai tha: “Kush mund të dëshpërohet nga mëshira e Zotit tim, përveç të devijuarve?!”

قَالَ وَمَنْ يَقْضُ مِنْ رَحْمَةِ رَبِّهِ إِلَّا  
الضَّالُّونَ ﴿٥٧﴾

58. (Dhe) tha: “Cili është qëllimi juaj, o të dërguar?”

قَالَ فَمَا حَظُّكُمْ أَيُّهَا الْمُرْسَلُونَ ﴿٥٨﴾

59. Thanë: “Ne jemi të dërguar drejt një populli fajtor.

قَالُوا إِنَّا أُرْسِلْنَا إِلَىٰ قَوْمٍ مُّجْرِمِينَ ﴿٥٩﴾

60. Bën përjashtim familja e Lutit. Sigurisht, ne do t'i shpëtojme ata që të gjithë,

إِلَّا آلَ لُوطٍ ۗ إِنَّا لَمُجْرِبُوهُمْ أَجْمَعِينَ ﴿٦٠﴾

61. përveç gruas së tij, (që ia) kemi llogaritur (fundin). Ajo do të jetë ndër të mbeturit pas.”

إِلَّا امْرَأَتَهُ قَدَرْنَا ۗ إِنَّا لَمِنَ الْغَابِرِينَ ﴿٦١﴾

62. E kur i erdhën të dërguarit familjes së Lutit,

فَلَمَّا جَاءَ آلَ لُوطٍ الْمُرْسَلُونَ ﴿٦٢﴾

63. (Luti) tha: “Qenkeni njerëz të panjohur!”

قَالَ إِنَّكُمْ قَوْمٌ مُّسْكِرُونَ ﴿٦٣﴾

64. Ata thanë: “Përkundrazi, të sollëm atë (lajm) për të cilin ata janë në dyshim.

قَالُوا بَلْ جِئْنَاكَ بِمَا كَانُوا فِيهِ يَمْتَرُونَ ﴿٦٤﴾

65. Dhe të erdhëm me të vërtetën dhe, sigurisht, ne jemi të vërtetë.

وَأَتَيْنَكَ بِالْحَقِّ وَإِنَّا لَصَادِقُونَ ﴿٦٥﴾

66. Andaj, dil me familjen tënde në një copë të natës dhe ti ndiqi ata. Asnjëri prej jush të mos e kthejë kokën pas dhe ecni ashtu siç jeni të urdhëruar.”

فَاسْرِبْ بِأَهْلِكَ بِقِطْعٍ مِّنَ اللَّيْلِ وَاتَّبِعْ  
أَدْبَارَهُمْ وَلَا يَلْتَفِتْ مِنْكُمْ أَحَدٌ  
وَأْمُصُوا حَيْثُ تُوْمَرُونَ ﴿٦٦﴾

67. Dhe Ne atij ia bëmë me dije këtë vendim që rrënja e tyre do të pritet në mëngjes.

وَقَضَيْنَا إِلَيْهِ ذَلِكَ الْأَمْرَ أَنَّ دَابِرَ هُوْلَاءِ  
مَقْطُوعٌ مُّصْحِحِينَ ﴿٧٧﴾

68. Erdhën banorët e qytetit, të gëzueshëm.

وَجَاءَ أَهْلَ الْمَدِينَةِ يَسْتَبْشِرُونَ ﴿٧٨﴾

69. Ai tha: “Këta janë mysafirët e mi, andaj mos më turpëroni.

قَالَ إِنَّ هَؤُلَاءِ ضَيْفِي فَلَا تَفْضَحُونِ ﴿٧٩﴾

70. Dhe kijeni drojën ndaj Allahut dhe mos më poshtëroni.”

وَاتَّقُوا اللَّهَ وَلَا تُخْرُونَ ﴿٨٠﴾

71. Ata thanë: “A nuk të kemi ndaluar nga (marrëdhëniet me) botët?!”

قَالُوا أَوَلَمْ نَنْهَكَ عَنِ الْعَالَمِينَ ﴿٨١﴾

72. Ai tha: “(Shikoni,) këto janë vajzat e mia. (Kini turp) nëse me të vërtetë doni të veproni!”<sup>10</sup>

قَالَ هَؤُلَاءِ بَنَاتِي إِنْ كُنْتُمْ فَعِلِينَ ﴿٨٢﴾

73. (Allahu shpalli): Për moshën tënde, (o Muhammed)! Njëmend, ata vërtiten në dehjen e tyre.

لَعَمْرُكَ إِنَّهُمْ لَفِي سَكْرَتِهِمْ يَعْمَهُونَ ﴿٨٣﴾

74. Prandaj, ata i zuri krisma në mëngjes.

فَأَخَذَتْهُمُ الصَّيْحَةُ مُشْرِقِينَ ﴿٨٤﴾

75. Atëherë e përmbysëm atë (vend) dhe lëshuam mbi ta rrebesh gurësh të përbërë prej dheut.

فَجَعَلْنَا عَلَيْهَا سَافِلَهَا وَأَمْطَرْنَا عَلَيْهِمْ  
حِجَارَةً مِنْ سِجِّيلٍ ﴿٨٥﴾

76. Pa dyshim, në këtë (ngjarje) ka shenja për kërkuesit.

إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِّمُتَوَسِّئِينَ ﴿٨٦﴾

77. Dhe ai (vendbanim) gjendet në një rrugë që vazhdon (të ekzistojë).

وَإِنَّهَا لِبِسْطِيلٍ مُّقِيمٍ ﴿٨٧﴾

78. Pa dyshim, në këtë ka shenjë për besimtarët.

إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَةً لِّلْمُؤْمِنِينَ ﴿٨٨﴾

10. Lexoni 11:80.

79. Dhe sigurisht (edhe) banorët e pyjeve ishin keqbërës.

وَأِنْ كَانَ أَصْحَابُ الْأَيْكَةِ لَظَالِمِينَ ﴿٧٩﴾

80. Andaj, u hakmorëm me ta, dhe të dyja këto (vendbanime) gjenden në një rrugë të dallueshme.

فَأَنْتَقَمْنَا مِنْهُمُ وَإِنَّهُمَا لَبِإِمَامٍ مُّبِينٍ ﴿٨٠﴾

81. Sigurisht, edhe banorët e Hixhrit i quajtën gënjeshtarë të Dërguarit.<sup>11</sup>

وَلَقَدْ كَذَّبَ أَصْحَابُ الْحَجْرِ الْمُرْسَلِينَ ﴿٨١﴾

82. Ne u patëm dhënë shenjat Tona, por ata i shpërfillnin.

وَأَتَيْنَهُمُ آيَاتِنَا فَكَانُوا عَنْهَا مُعْرِضِينَ ﴿٨٢﴾

83. Ata gdhendnin male (shkëmb-injsh) për të bërë shtëpi në mënyrë të sigurt.

وَكَانُوا يُبْحِثُونَ مِنَ الْجِبَالِ بُيُوتًا أَمِينٍ ﴿٨٣﴾

84. Atëherë, (edhe) ata i zuri krisma në mëngjes.

فَأَخَذَتْهُمُ الصَّيْحَةُ مُصْحِينَ ﴿٨٤﴾

85. Kështu, nuk u vlejti dot ajo që ata punonin.

فَمَا أَغْنَىٰ عَنْهُمْ مَا كَانُوا يَكْسِبُونَ ﴿٨٥﴾

86. Ne nuk krijuam qiejt dhe tokën dhe gjithçka që është mes të dyjave, përveçse me vërtetësi. Dhe Ora do të vijë patjetër. Andaj, tolero me tolerancën më të mirë.

وَمَا خَلَقْنَا السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ وَمَا بَيْنَهُمَا إِلَّا بِالْحَقِّ وَإِنَّ السَّاعَةَ لَأَيُّمٌ ﴿٨٦﴾  
فَاصْفَحْ الصَّفْحَ الْجَمِيلَ ﴿٨٧﴾

87. Njëmend, pikërisht Zoti yt është Krijuesi i përsosur, i Gjithëdijshmi.

إِنَّ رَبَّكَ هُوَ الْخَلْقُ الْعَلِيمُ ﴿٨٧﴾

88. Sigurisht, Ne të dhamë shtatë (vargje) që përsëriten<sup>12</sup> dhe Kuranin

وَلَقَدْ آتَيْنَاكَ سَبْعًا مِّنَ الْمَثَانِي وَالْقُرْآنَ

11. Hixhri shtrihet midis Tebukut dhe Medinës. Këtu jetonte fisi Themud tek i cili u dërgua Profeti Salih<sup>as</sup> si paralajmërues. *Hixhr* në arabisht do të thotë *gur*. Mundet që qyteti të ishte ndërtuar kryesisht me gurë, ose i rrethuar nga një ledhe guri, gjë që mund të jetë shkak i këtij toponimi.

12. Fjalët “shtatë (vargje) që përsëriten” me sa duket nënkuptojnë shtatë ajetet e sures El-

e madhërishëm.

الْعَظِيمَ ﴿٨٨﴾

89. Mos i hap sytë ndaj asaj që u kemi dhënë disa prej grupeve të tyre si mjet të përkohshëm, mos u brengos për ta dhe afroje krahun tënd (të mëshirës) për besimtarët.

لَا تَمُدَّنْ عَيْنَيْكَ إِلَىٰ مَا مَتَّعْنَا بِهِ أَزْوَاجًا مِنْهُمْ وَلَا تَحْزَنْ عَلَيْهِمْ  
وَاخْفِضْ جَاْحَكَ لِلْمُؤْمِنِينَ ﴿٨٩﴾

90. Dhe thuaj: “Unë jam alarmuesi i qartë,

وَقُلْ إِنِّي أَنَا النَّذِيرُ الْمُبِينُ ﴿٩٠﴾

91. (për ndëshkimin)”, siç kishim zbritur mbi grupet e ndara,

كَمَا أَنْزَلْنَا عَلَى الْمُقْتَسِمِينَ ﴿٩١﴾

92. të cilët e bënë Kuranin copë-copë.

الَّذِينَ جَعَلُوا الْقُرْآنَ عِضِينَ ﴿٩٢﴾

93. Për Zotin tënd! Ne patjetër do t'i pyesim ata të gjithë,

فَوَرَبِّكَ لَنَسْأَلَنَّهُمْ أَجْمَعِينَ ﴿٩٣﴾

94. për atë që ata bënëin.

عَمَّا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿٩٤﴾

95. Prandaj, tregoje qartazi atë që të është urdhëruar dhe anashkalo idhujtarët.

فَأَصْدَعْ بِمَا تُؤْمَرُ وَأَعْرِضْ عَنِ  
الْمُشْرِكِينَ ﴿٩٥﴾

96. Sigurisht, Ne të mjaftojmë kundër përqeshësve.

إِنَّا كَفَيْكَ الْمُسْتَهْزِئِينَ ﴿٩٦﴾

97. Të cilët bënë një të adhureshëm tjetër me Allahun. Së shpejti do ta mësojnë.

الَّذِينَ يَجْعَلُونَ مَعَ اللَّهِ إِلَهًا آخَرَ  
فَسَوْفَ يَعْلَمُونَ ﴿٩٧﴾

98. Vërtet, Ne e dimë që ty të ngushtohet kraharori nga ajo që ata thonë.

وَلَقَدْ نَعْلَمُ أَنَّكَ يَضِيقُ صَدْرَكَ بِمَا  
يَقُولُونَ ﴿٩٨﴾

Fatiha, kuptimet e të cilave gjenden nëpër gjithë Kuranin e Shenjtë. Gjithashtu, të gjitha shkurtesat Kuranore duket se janë marrë nga surja El-Fatiha, sepse shkurtesat nuk kanë asnjë shkronjë që nuk gjendet në El-Fatiha, dhe nga ana tjetër, El-Fatihaja ka shtatë shkronja të tilla, që nuk janë përdorur në shkurtesat Kuranore.



99. Prandaj, përkujto Zotin tënd me lavdërimin e Tij dhe bëhu ndër ata që bëjnë sexhde.

فَسَبِّحْ بِحَمْدِ رَبِّكَ وَكُنْ مِنَ السَّاجِدِينَ ﴿٩٩﴾

100. Dhe adhuroje Zotin tënd, deri sa të të vijë bindja.<sup>13</sup>

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اسْجُدُوا لِلَّهِ رَبِّكَ حَتَّىٰ يَأْتِيَكَ الْيَقِينُ ﴿١٠٠﴾

13. Besimtari e ka për detyrë të mos lodhet nga *ibadeti* (adhurimi) dhe të mos tregohet i ngathët, për sa kohë që jeta e tij e gënjeshtërt nuk ftohet plotësisht dhe në vend të saj, ai të fillojë një jetë të re, një jetë të qëndrueshme dhe të lumtur. Për sa kohë që besimtarit nuk i largohet “djegia” e kësaj bote të përkohshme, që ajo të zëvendësohet me një kënaqësi në besim dhe një qëndrueshmëri në shpirt dhe një lumturi në jetë, deri atëherë njeriut nuk i quhet i përsosur besimi. Për këtë arsye Allahu i Madhërishtëm në këtë ajet e porositi njeriun – Vazhdo ta adhurosh Zotin, gjersa të arrish pozitën e bindjes së përsosur dhe ty të largohen të gjitha perdet e errësirës dhe të kuptosh se tani nuk je ai që ishe më përpara, madje tani kjo botë është e re, kjo tokë e re e ky qiell i ri, e të ndiesh se ke fituar një jetë të dytë. Këtë jetë sufistët e hershëm e kanë quajtur “ringjallje” që në jetën e kësaj bote (arab. *bekā*). Njeriu kur e arrin këtë gradë, Zoti fryn në të prej Shpirtit të Tij dhe atij i zbrasin engjëj. Kjo është arsyeja që i Dërguari i Allahut<sup>sav</sup> kishte thënë për *Hazret Ebu Bekrin*<sup>ra</sup> – Nëse dikush do që të shohë një të vdekur [për nga mëkatet] që ecën në tokë, le të shohë Ebu Bekrin (Sha’rani, Levakih, 887). Pozita e Ebu Bekrit nuk ishte vetëm për shkak të veprave të tij, por edhe për shkak të asaj që ai e kishte në zemër. Kur besimtari arrin këtë gradë, për të Zoti thotë – Unë e dua atë e më pas, Unë bëhem veshi i tij, me të cilin ai dëgjon; bëhem syri i tij me të cilin ai shesh; bëhem dora e tij, me të cilën ai prek; bëhem këmba e tij, me të cilën ai ecën; kur ai Më kërkon diçka, ia jap; kur Më kërkon mbrojtje nga djalli ose nga armiku, e mbroj. (Buhari, nr. 6502).

## Surja 16 – En-Nahl

Surja En-Nahl është mekase dhe bashkë me *bismil-lahin*, ka njëqind e njëzet e nëntë ajete.

Një kuptim i fjalës “bindja” që u përmend në fund të sures së mëparshme, u mor edhe “vdekja”, megjithatë, kuptimi i parë mbetet bindje. Kjo sure fillon me pohimin: Çështja bindëse që të ishte premtuar ty, thuajse ka ardhur, andaj, o mohues, mos e kërkoni që ajo të bjerë me nxitim dhe dijeni se Zoti i Madhërishëm i dërgon kujt të dojë engjëjt e Tij prej qiellit.

Pasi përmend krijimin e të gjitha llojeve të shtazëve ku disa prej tyre përdoren edhe si mjet transporti, kjo sure bën një profeci madhështore duke thënë: Pas këtyre, Zoti i Madhërishëm do të krijojë disa mjete të tjera transporti, për të cilat nuk ju është dhënë dijeni ende. Në këtë mënyrë, ajeti në fjalë parashikoi mjete transporti nga më të rejat që do të dilnin në të ardhmen.

Më pas thuhet se çdo kafshë dhe çdo bimësi mbijeton falë ujit që zbret prej qiellit. Gjithashtu, ka edhe një ujë tjetër qiellor, të cilin shtazët dhe bagëtitë (*en'am*) që hanë barin, nuk e perceptojnë dot. Ky ujë shpirtëror dhe jetëdhënës u jepet të Dërguarve të Zotit, të cilët ua çojnë edhe njerëzve të tjerë, por ata njerëz, të cilët sipas Kuranit të Shenjtë, u përngajnë shtazëve (*en'am*), nuk e rrokin dot atë. Kafshëve të vërteta nuk u është dhënë aftësia e perceptimit, por njerëzit që duke e pasur këtë aftësi, madje pretendojnë ta kuptojnë fenë, por sërish e privojnë veten për të përfutuar nga ky ujë shpirtëror, sipas Kuranit të Shenjtë, janë më të degraduar se shtazët (*esherr-rru*).

Pas kësaj, duke përmendur bekime të shumta të Zotit të Madhërishëm, kjo sure vë në dukje bekimet që gjenden në ujin e kripur të deteve. Peshqit dhe gjallesat që pavarësisht se jetojnë në një mjedis me kaq shumë kripë, mishi i tyre që u shërbehet njerëzve nuk ka shije të kripur. Vihet në dukje fakti që ky sistem vaditjeje për jetën e gjallesave varet edhe nga malet që janë të ngulitura thellë në tokë. Po të mos ishin malet, nuk mund të bëhej as ciklimi i ujit të detit përmes avullimit dhe shiut.

Duke përshkruar hijet, Kurani i Shenjtë thotë se ato sikur janë në sexhde përpara Zotit. Por thotë se edhe kafshët e tokës dhe engjëjt i bëjnë sexhde Zotit të Madhërishëm. Kafshët e tilla, duke kërkuar ushqim në sipërfaqen e tokës, në njëfarë mënyre, janë në sexhde përpara Krijuesit të tyre. Gjithashtu edhe engjëjt që e njohin ujin shpirtëror prej qiellit, përulen në sexhde përpara Zotit të Madhërishëm.

Ajeti 62 shpalos një temë befasuese që, nëse Allahu i Madhërishëm do të fillojë të shtrëngojë njeriun menjëherë pas çdo padrejtësie të tij, Ai do t'i asgjësojë të gjitha gjallesat që ecin në faqen e dheut. Kjo nënkupton që po të mos ishin gjallesat e tjera të tokës, mbijetesa e njeriut do të bëhej e pamundur. Prandaj, menjëherë pas kësaj i jepet mesazh njeriut: Keni shumë mësimë në bagëti.

Pas kësaj, kjo sure tregon madhështinë e shpalljes, duke dhënë shembullin e bletës. Përveç bletës, Kurani nuk përmend ndonjë gjallesë tjetër, së cilës t'i jetë dhënë shpallja. Në dukje edhe bleta është një mizë, si miza e zakonshme që jeton në papastërti, por dallimi mes të dyjave është se Zoti i Madhërishëm nëpërmjet shpalljes e pastroi bletën nga çdo papastërti, prandaj, ajo edhe hojet i ndërton në lartësi nëpër male, nëpër pemë e nëpër vreshta të larta. Sipas Kuranit, ajo është mësuar përmes shpalljes që të marrë nektarin e çdo luleje. Kurani përdori fjalën *themer* (frutë), në vend të nektarit, dhe kjo mbart dy urtësi. Së pari, fruta del pikërisht pas thithjes së nektarit nga bleta, dhe së dyti, ajo merr esencën e frutës pikërisht nga lulja. Në mjaltin që ajo prodhon me këtë proces, Zoti i Madhërishëm ka vënë shërim të jashtëzakonshëm për njerëzit.

Fjalët “(mjalti) del nga barqet e tyre...” tregojnë që mjalti nuk bëhet vetëm nga nektari i luleve, por bëhet kur bleta e përzien atë me pështymën e saj, duke nxjerrë jashtë gjuhën vazhdimisht, që lëngu të trashet për t'u shndërruar më në fund në mjaltë, të cilin bleta e grumbullon nëpër hoje.

Pas kësaj jepet shembulli i dy shërbëtorëve, një që është aq naiv saqë nuk sjell asnjë mbarësi në punët e tij, dhe i dyti, të cilit Allahu i jep ushqim të pastër dhe që ai e shpenzon edhe për të mirën e njerëzve. Edhe ky shembull ka lidhje të fortë me bletën. Miza e thjeshtë i përngjan shërbëtorit që nuk sjell asnjë hair. Kurse bleta i përngjan shërbëtorit tjetër të cilit Allahu i jep ushqim të pastër dhe që, më pas, ai e “shpërndan” për dobinë e njerëzimit.

Më pas, surja En-Nahl vijon shembuj të shërbëtorëve të ndryshëm, duke i aplikuar ata mbi njerëzit. Një shërbëtor është ai që nuk bekohet me shpalljen e Zotit të Madhërishëm dhe e pandeh Zotin për memec, por në të vërtetë ai vetë është memec. Për të thuhet se çfarëdo pune që nis, i shkon në humbje. “Ai humbi edhe në këtë botë, edhe në *ahiret*”. Por ka edhe një lloj tjetër shërbëtorësh, që janë Profetët e Zotit, të cilët u japin njerëzve mësimin e drejtësisë dhe edhe vetë gjithmonë ecin në rrugën e drejtë. Të mos harrojmë që edhe bletës i ishte dhënë e njëjta porosi: “Ndiq rrugët e Zotit tënd!” Megjithatë, Profetët kanë edhe një epërsi tjetër mbi bletën: ata ndjekin rrugën që patjetër të çon tek Allahu i Madhërishëm.

Po në këtë sure flitet edhe për shpendët duke thënë se mos mendoni se ata rastësisht kanë fituar krahët për të fluturuar në qiell. Realisht, krahët vetëm nuk ua bëjnë të mundur fluturimin, derisa Zoti nuk do t'i pajiste me kocka boshe, me një gjoks që përveçse ka një strukturë të veçantë, në të dyja anët e vet ka muskuj të fuqishëm, që arrijnë ta mbajnë gjithë peshën dhe i bëjnë shpendët të fluturojnë. Krijimi i tyre është një mrekulli befasuese. Ka disa shpendë që kanë peshë të madhe, por arrijnë të fluturojnë mijëra kilometra. Forma e tyre gjatë fluturimit bëhet sikur një avion, që ata ta shpërndajnë ajrin për të ndier sa më pak presion. Ai që qëndron në krye të tufës për ta përballuar i pari presionin e ajrit, herë pas here zëvendësohet me një tjetër për të bërë të njëjtën detyrë. Po prej tyre janë edhe pata deti që, pavarësisht

nga pesha, nuk zhyten. Arsyeja e moszhytjes së tyre është që puplat e vogla të tyre e ruajnë ajrin, që u jep mundësi për të notuar në ujë. Kjo nuk mund të ndodhte vetvetiu, sepse puplat kishin nevojë për një lëndë ngjitëse, e cila t'i mbronte ato nga lagështia. Mund të keni vënë re që shpendët vazhdimisht i fërkojnë puplat me sqepin e tyre. Është e habitshme që Zoti i Madhërishëm u mundëson një lëndë të ngjashme me graso, me të cilën ata i "grasojnë" puplat e tyre. Si erdhi kjo lëndë?! Si mbërriti ajo deri te sqepat e tyre?! Si u vetëdijesuan këta shpendë që me këtë ta "grasonin" trupin që të ruhen nga lagështia dhe të mos zhyten?!

Në vijim, Kurani i Shenjtë tregon mrekullinë e tij që ai shpjegon çdo gjë dhe kjo është një epërsi e tij mbi Librat e tjerë. E njëjta epërsi i është dhënë edhe Profetit Muhammed<sup>savs</sup> mbi Profetët e tjerë. Për këtë arsye, në këtë sure thuhet se, Profetët e mëparshëm kanë qenë dëshmitarë mbi popujt e tyre, kurse Profeti Muhammed<sup>savs</sup> është dëshmitar mbi Profetët.

Mësimi i Kuranit mbulon çdo aspekt. Si shembull është ajeti 91, i cili përfshin të gjitha mësimet morale dhe shpirtërore. Ky ajet na thotë se më së pari duhet të bëjmë drejtësi ('*adl*), pa të cilën nuk mund të pritet asnjë përmirësim në botë. Më pas na këshillon të bëjmë mirësi (*ihsan*), gjë që është një shkallë më lart se drejtësia. Më pas, Kurani na çon në shkallën e fundit, të *itaidhil-kurba*, që do të thotë se njeriu duhet të shërbejë ndaj njerëzve të tjerë me një dhembshuri amnore, pra, sikur një nënë që u shërben fëmijëve të vet, pa pasur dëshirë për asnjë lloj vlere në këmbim. Kjo shkallë e lartë i ishte dhënë Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, sepse ai ishte i pastër nga çdo interes dhe, me vetëmohim të përsosur, i bekonte të gjithë njerëzit.

Në fund të kësaj sureje, *Hazret Ibrahim*<sup>as</sup> që ishte një njeri, u quajt si një popull i tërë. Kjo sepse përmes tij do të lindnin shumë popuj, duke kulmuar përfundimisht tek Profeti Muhammed<sup>savs</sup>. Prandaj, Profetit Muhammed<sup>savs</sup> iu shpall të ndiqte praktikën e *Hazret Ibrahim*<sup>as</sup> dhe ai u porositi të bënte thirrje drejt Zotit me urtësi dhe këshillë të mirë. Por kjo detyrë kërkon durim të skajshëm. Edhe porosia që gjendet në krye të kësaj sureje "Mos e kërkonit të vijë shpejt!" (ajeti nr. 2), mbart të njëjtën temë. Ndryshimet e mëdha shpirtërore nuk vijnë përnjëherë, por për to duhet shumë punë me durim të skajshëm. Por ky durim nuk mund të arrihet pa pasur *takva* (druajtje ndaj Zotit), madje, ai u jepet më së shumti atyre që bëjnë *ihsan* (mirësi).

Këtu fjala *ihsan* i referohet asaj që u tha në ajetin "Allahu urdhëron drejtësinë dhe mirësinë (*ihsanin*)...", por një shpjegim i saj gjendet edhe në fjalën e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>. Duke shpjeguar *ihsanin*, ai tha: Kur të adhurosh Zotin, të arrish ta shohësh Zotin, dhe shkalla më e vogël e *ihsanit* është që ta adhurosh Atë duke qenë i bindur se Ai të sheh ty. (Sahih Buhari, kitab: "El-iman", hadithi nr. 50.)



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. “Ja po vjen urdhri i Allahut, prandaj, mos e kërkoni të vijë shpejt.” I shenjtë është Ai dhe i pastër nga gjithçka që ata e bëjnë ortak me Të.

أَتَى أَمْرُ اللَّهِ فَلَا تَسْتَعْجِلُوهُ ۗ سُبْحٰنَهُ  
وَتَعَالَىٰ عَمَّا يُشْرِكُونَ ②

3. Ai me urdhrin e Tij i zbret engjëjt me Shpirtin e shenjtë<sup>1</sup> mbi kë të dojë nga robërit e Tij: “Paralajmëroni që nuk ka të adhurueshëm tjetër përveç Meje, andaj, prej Meje kini druajtje!”

يُنزِلُ الْمَلَائِكَةَ بِالرُّوحِ مِنْ أَمْرِهِ عَلَىٰ  
مَنْ يَشَاءُ مِنْ عِبَادِهِ أَنْ أَنْذِرُوا أَنَّهُ  
لَا إِلَهَ إِلَّا أَنَا فَاتَّقُونِ ③

4. Ai krijoi qiejt dhe tokën me vërtetësi; është i pastër nga gjithçka që ata e bëjnë ortak me Të.

خَلَقَ السَّمٰوٰتِ وَالْاَرْضَ بِالْحَقِّ ۗ تَعَالَىٰ  
عَمَّا يُشْرِكُونَ ④

5. Ai krijoi njeriun nga sperma dhe ja ai u bë grindavec i hapur!

خَلَقَ الْاِنْسَانَ مِنْ نُّطْفَةٍ ۗ فَاِذَا هُوَ  
حٰصِيْمٌ مُّمِيْنٌ ⑤

6. Edhe bagëtitë i krijoi. Në to keni mjete të ngrohjes, dobi (të shumta) dhe ju prej tyre ushqeheni.

وَالْاَنْعَامَ خَلَقَهَا لَكُمْ فِيْهَا دِفْءٌ  
وَمَنْٰفِعٌ وَمِنْهَا تَاْكُلُوْنَ ⑥

7. Në to keni edhe bukuri kur i ktheni nga kullota dhe kur i lëshoni (në mëngjes) për të kullotur.

وَلَكُمْ فِيْهَا جَمَالٌ حِيْنَ تَرِيْحُوْنَ وَحِيْنَ  
تَسْرَحُوْنَ ⑦

8. Ato mbartin barrët tuaja deri në një vendbanim (tjetër), ku ju vet nuk mund t'i mbartnit përveçse duke e

وَتَحْمِلُ اَنْقَالَكُمْ اِلَىٰ بَلَدٍ لَّمْ تَكُوْنُوْا  
بِلٰغِيْهِ اِلَّا بِشِقِّ الْاَنْفُسِ ۗ اِنَّ رَبَّكُمْ

1. Në arabisht, fjala është *ruh*, (që do të thotë shpirt, esencë; shpallje Hyjnore; etj.. fjalori Lane), këtu nënkuptohet Fjala jetëdhënëse e Zotit.

munduar veten. Sigurisht, Zoti juaj është shumë i Dhembshur, shumë Mëshirëbërës.

لَرَّءُوفٌ رَّحِيمٌ ۝۸

9. Edhe kuajt, edhe mushkat, edhe gomarët (Ai i krijoi), që ju të hipni në to, dhe (i krijoi edhe) për zbukurim.<sup>2</sup> Dhe Ai do të krijojë (edhe atë) që ju nuk e dini.<sup>3</sup>

وَ الْخَيْلِ وَالْبِغَالِ وَالْحَمِيرِ لَتَرْكَبُوهَا  
وَزِينَةً ۞ وَيَخْلُقُ مَا لَا تَعْلَمُونَ ۝۹

10. Tregimi i udhës së drejtë është detyrim mbi Allahun (ndaj robërve), dhe prej atyre (rrugëve) ka disa të shtrembëta. Sikur të donte Ai, do t'ju udhëzonte të gjithë ju.

وَعَلَى اللَّهِ قَصْدُ السَّبِيلِ وَمِنْهَا جَائِرٌ ۞  
بِخٍ وَلَوْ شَاءَ لَهَدَاكُمْ أَجْمَعِينَ ۝۱۰

11. Është Ai që zbriti prej qiellit ujë për ju, të cilin e pini, prej të cilit është bimësia dhe në të cilën kullotni (bagëtitë).

هُوَ الَّذِي أَنْزَلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً لَكُمْ مِنْهُ  
شَرَابٌ وَمِنْهُ شَجَرٌ فِيهِ تُسِيمُونَ ۝۱۱

12. Prej tij Ai nxjerr për ju drithërat, ullirin, hurmën, rrushin dhe nga çdolloj frute (tjetër). Pa dyshim, në të ka shenjë për njerëzit që meditojnë.

يُثْبِتُ لَكُمْ بِهِ الزَّرْعَ وَالزَّيْتُونَ  
وَالنَّخِيلَ وَالْأَعْنَابَ وَمِنْ كُلِّ الثَّمَرَاتِ ۞  
إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَةً لِّقَوْمٍ يَتَفَكَّرُونَ ۝۱۲

13. Dhe Ai nënshtroi për ju natën dhe ditën, diellin dhe hënën; edhe yjet janë të nënshtuara prej urdhrit të Tij. Pa dyshim, në të ka shumë shenja për njerëzit që kuptojnë.

وَسَخَّرَ لَكُمْ الَّيْلَ وَالنَّهَارَ ۞ وَالشَّمْسَ  
وَالْقَمَرَ ۞ وَالنُّجُومَ مَسخَرَاتٍ بِأَمْرِهِ ۞  
إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِّقَوْمٍ يَعْقِلُونَ ۝۱۳

2. Përderisa Zoti është kujdesur me kaq detaje për të siguruar nevojat fizike dhe materiale të njeriut, nuk mund të ketë asnjë fije dyshimi në faktin se Ai është kujdesur, të paktën në të njëjtën masë, edhe për nevojat shpirtërore të njeriut.

3. Fjalët "Ai do të krijojë (edhe atë) që ju nuk e dini", bëjnë profeci që do të dilnin mjete të reja transporti që, në kohën kur u zbrit Kurani, ishin të panjohura për njeriun. Mjetet e avancuara të transportit, qofshin rrugore, qofshin detare, qofshin ajrore, janë dëshmi të përmbushjes së kësaj profecie.

14. Dhe Ai krijoi për ju gjëra të ndryshme në tokë. Sigurisht, në të ka shenjë për njerëzit që mendojnë.

وَمَا ذَرَأَ لَكُمْ فِي الْأَرْضِ مُخْتَلِفًا أَلْوَانُهُ  
إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَةً لِّقَوْمٍ يَتَذَكَّرُونَ ﴿١٤﴾

15. Është Ai që nënshtroi edhe detin që ju të hani mish të freskët prej tij dhe të nxirrni stoli prej tij, të cilat ju i mbani. Ti sheh anijet që lundrojnë duke çarë ujën në të, që ju të kërkoni prej bekimit të Tij dhe që të falënderoni.

وَهُوَ الَّذِي سَخَّرَ الْبَحْرَ لِتَأْكُلُوا مِنْهُ لَحْمًا  
طَرِيًّا وَتَسْتَخْرِجُوا مِنْهُ حَبْلَةً تَلْبَسُونَهَا  
وَتَرَى الْفُلْكَ مَوَاجِرَ فِيهِ وَلِيَبْتَلُوا مِنْ  
فَضْلِهِ وَلَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ ﴿١٥﴾

16. Dhe Ai vuri malet në tokë që ato t'ju furnizojnë,<sup>4</sup> dhe lumenj dhe rrugë, që ju të udhëzoheni.

وَأَلْقَى فِي الْأَرْضِ رَوَاسِيَ أَنْ تَمِيدَ بِكُمْ  
وَأَنْهَارًا وَسُبُلًا لَعَلَّكُمْ تَهْتَدُونَ ﴿١٦﴾

17. Dhe shenja referimi. Edhe me yjet ata udhëzohen.

وَعَلَّمَتْهُ وَالنَّجْمِ هُمْ يَهْتَدُونَ ﴿١٧﴾

18. Ai që krijon a është si ai që nuk krijon?! A nuk mendoni?!

أَفَمَنْ يَخْلُقُ كَمَنْ لَا يَخْلُقُ أَفَلَا  
تَتَذَكَّرُونَ ﴿١٨﴾

19. Dhe nëse numëroni bekimet e Allahut, nuk i llogaritni dot. Sigurisht, Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

وَإِنْ تَعَدُّوا نِعْمَةَ اللَّهِ لَا تُحْصُوهَا إِنَّ  
اللَّهَ لَعَفُورٌ رَحِيمٌ ﴿١٩﴾

20. Allahu e di atë që fshihni dhe atë që shfaqni.

وَاللَّهُ يَعْلَمُ مَا تُسْرُونَ وَمَا تَعْلَنُونَ ﴿٢٠﴾

21. Dhe (idhujt) të cilët ata i lusin në vend të Allahut, nuk krijojnë asgjë, madje ata vetë janë të krijuar;

وَالَّذِينَ يَدْعُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ لَا يَخْلُقُونَ  
شَيْئًا وَهُمْ يُخْلَقُونَ ﴿٢١﴾

22. janë të vdekur, jo të gjallë, dhe nuk dinë kur do të ringjallen.<sup>5</sup>

أَمْوَاتٌ غَيْرٌ أَحْيَاءٍ وَمَا يَشْعُرُونَ  
بِأَيَّانَ يُبْعَثُونَ ﴿٢٢﴾

4. Fjalët "en temide bikum", do të thotë që të shtrojnë sofër (arab. maide) për ju. Një kuptim tjetër i kësaj është: që të (mos) ju luhatin.

5. Ajetet 21-22 deklarojnë qartazi se njerëzit, të cilët ishin kthyer në idhuj dhe që adhuroheshin

23. I Adhureshmi juaj është Një i Adhureshëm i Vetëm. Ndaj, ata që nuk besojnë në *ahiret*, zemrat e tyre janë mohuese dhe ata janë mendjemëdhenj.

الْهَكْمُ إِلَهٌ وَاحِدٌ ۚ فَالَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ  
بِالْآخِرَةِ قُلُوبُهُمْ مُّكْرَرَةٌ وَ هُمْ  
مُسْتَكْبِرُونَ ﴿١٣﴾

24. Pa dyshim që Allahu e di atë që ata fshehin si dhe atë që shfaqin. Sigurisht, Ai nuk i do mendjemëdhenjtë.

لَا جَرَءَ أَنَّ اللَّهَ يَعْلَمُ مَا يُسِرُّونَ وَمَا  
يُعْلِنُونَ ۗ إِنَّهُ لَا يُحِبُّ الْمُسْتَكْبِرِينَ ﴿١٤﴾

25. Dhe kur i pyet ata: “Çfarë ka zbritur Zoti juaj?”, thonë: “Përrallat e të parëve”.

وَإِذَا قِيلَ لَهُمْ مَاذَا أَنْزَلَ رَبُّكُمْ ۗ قَالُوا  
أَسَاطِيرُ الْأَوَّلِينَ ﴿١٥﴾

26. (Me këtë sikur duan) të mbartin të gjitha barrët e veta Ditën e Kiametit dhe barrët e atyre që i devijonin pa pasur dije. Eh, sa e keqe është ajo që ata mbartin!

لِيَحْمِلُوا أَوْزَارَهُمْ كَامِلَةً يَوْمَ الْقِيَامَةِ  
وَمِنْ أَوْزَارِ الَّذِينَ يُضِلُّونَهُمْ بِغَيْرِ عِلْمٍ ۗ  
ۚ أَلَا سَاءَ مَا يَزُرُونَ ﴿١٦﴾

27. Edhe ata që ishin para tyre bënë strategji, atëherë Allahu ua shkuli pallatet nga themelet dhe atyre u ranë çatitë nga sipër. Atyre u erdhi ndëshkimi prej atje ku ata nuk imagjinonin.

قَدْ مَكَرَ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ فَآتَى اللَّهُ  
بَيِّنَاتِهِمْ مِنَ الْقَوَاعِدِ فَخَرَّ عَلَيْهِمُ السَّقْفُ  
مِنْ فَوْقِهِمْ وَأَتَاهُمُ الْعَذَابُ مِنْ حَيْثُ  
لَا يَشْعُرُونَ ﴿١٧﴾

28. Më pas Ditën e Kiametit Ai do t'i poshtërojë ata dhe do t'u thotë: “Ku janë ortakët e Mi, për hir të të cilëve ju kundërshtonit?!” Atyre

ثُمَّ يَوْمَ الْقِيَامَةِ يُخْزِيهِمْ وَيَقُولُ  
أَيْنَ شُرَكَائِيَ الَّذِينَ كُنْتُمْ تُشَاقِقُونَ  
فِيهِمْ ۗ قَالَ الَّذِينَ أُوتُوا الْعِلْمَ إِنَّ

nga të krishterët, idhujtarët arabë a kushdo tjetër, janë të vdekur dhe nuk janë të gjallë. Nëse do të bënim një listë të njerëzve që adhurohen në botë, më në krye do të dilte emri i Jezusit<sup>as</sup>, i cili pa të drejtë adhurohet nga të krishterët si biri i Zotit. Andaj, i pari të cilin këto ajete deklarojnë si të vdekur, është pikërisht *Hazret Isai*<sup>as</sup>. Nuk duhet të harrojmë se ne si muslimanë besojmë se këto ajete janë fjalë të Zotit, dhe nëse *Hazret Isai*<sup>as</sup> do të ishte ende i gjallë, ato do të ishin një lapsus, gjë që asnjë besimtar nuk ia atribuon Zotit. Andaj, besimi se *Hazret Isai*<sup>as</sup> është ende i gjallë, bie ndesh me shumë ajete të Kuranit. Më shumë për këtë temë lexoni 5:116-118; 3:56; 3:145; 21:9.



që u është dhënë dije, do të thonë: “Sot, poshtërimi dhe e keqja u ra mohuesve!”

29. (Këta janë ata,) të cilëve engjëjt ua marrin shpirtin kur ata janë duke i bërë keq vetvetes, dhe përpiqen t’u thonë fjalën e kompromisit: “Ne nuk bënim ndonjë të keqe!” “Si jo?! Allahu është i Gjithëdijshëm për atë që bënit.

30. Hyni në portat e xhehenemit, në të cilin do të mbeteni gjatë. Është shumë e keqe streha e mendjemdhenje!”

31. Dhe atyre që patën druajtje (ndaj Zotit) do t’u thuhet: “Çfarë ka zbritur Zoti juaj?” Ata do të thonë: “Mirësi!” Ata që bënë mirësi në këtë botë, do të kenë mirësi, dhe shtëpia e *ahiretit* është më e mira. Sa e mirë është shtëpia e të druajturve (ndaj Zotit)!

32. Janë kopshte të përhershme ku do të hyjnë ata, në të cilat rrjedhin lumenj. Në to ata do të kenë çfarë të dëshirojnë.<sup>6</sup> Kështu i shpërblen Allahu të druajturit (ndaj Tij)!

33. (Këta janë ata,) të cilëve engjëjt ua marrin shpirtin kur ata janë të pastër (dhe engjëjt u) thonë: “Paqe qoftë mbi ju! Hyni në xhenet për shkak të asaj që bënit!”

الْخِزْيَ الْيَوْمَ وَالسُّوءَ عَلَى الْكَافِرِينَ ﴿١٧﴾

الَّذِينَ تَوَفَّيْتُمُ الْمَلَائِكَةَ طَالِبِي أَنْفُسِهِمْ  
فَأَقْبُوا السَّلَامَ مَا كُنَّا نَعْمَلُ مِنْ سُوءٍ  
بَلَىٰ إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ بِمَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ ﴿١٨﴾

فَادْخُلُوا أَبْوَابَ جَهَنَّمَ خَالِدِينَ فِيهَا  
فَلَيْسَ مَثْوًى الْمُتَكَبِّرِينَ ﴿١٩﴾

وَقِيلَ لِلَّذِينَ اتَّقَوْا مَاذَا أَنْزَلَ رَبُّكُمْ  
قَالُوا خَيْرًا لِلَّذِينَ أَحْسَنُوا فِي هَذِهِ  
الدُّنْيَا حَسَنَةٌ وَلَدَارُ الْآخِرَةِ خَيْرٌ  
وَلِنِعْمَ دَارُ الْمُتَّقِينَ ﴿٢٠﴾

جَثَّتْ عَدْنٌ يَدْخُلُونَهَا تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا  
الْأَنْهَارُ لَهُمْ فِيهَا مَا يَشَاءُونَ كَذَلِكَ  
يَجْزِي اللَّهُ الْمُتَّقِينَ ﴿٢١﴾

الَّذِينَ تَوَفَّيْتُمُ الْمَلَائِكَةَ طَيِّبِينَ  
يَقُولُونَ سَلَامٌ عَلَيْكُمْ لَا ادْخُلُوا الْجَنَّةَ  
بِمَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ ﴿٢٢﴾

6. Dëshirat e atyre që patën druajtje ndaj Allahut, do të njësohen me Vullnetin dhe pëlqimin e Allahut. Kështu që, ata do të dëshirojnë vetëm atë që Vullneti i Allahut do t’ua dhurojë. Për kopshtet dhe lumenjtë e xhenetit, lexoni 2:26.

34. A presin ata vetëm që t'u vijnë engjëjt ose t'u vijë urdhri i Zotit tënd?! Kështu bënë ata që ishin para tyre. Allahu nuk u bëri keq atyre, përkundrazi, ata i bënë keq vetvetes.

هَلْ يَنْظُرُونَ إِلَّا أَنْ تَأْتِيَهُمُ الْمَلَائِكَةُ أَوْ يَأْتِيَ أَمْرٌ رَّبِّكَ كَذَلِكَ فَعَلَ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ وَمَا ظَلَمَهُمُ اللَّهُ وَلَكِنْ كَانُوا أَنْفُسَهُمْ يَظْلِمُونَ ﴿٢٤﴾

35. Andaj, të këqijat e asaj që ata bënë, i goditën, dhe ajo me të cilën talleshin, i rrethoi.<sup>7</sup>

فَأَصَابَهُمْ سَيِّئَاتٌ مَا عَمِلُوا وَحَاقَ بِهِمْ غُيٌّ مِمَّا كَانُوا بِهِ يَسْتَهْرِءُونَ ﴿٢٥﴾

36. Ata që i atribuuan ortak (Allahut), thanë: “Po të donte Allahu, nuk do të adhuronim asgjë tjetër përveç Atij as ne dhe as baballarët tanë dhe as nuk do të ndalonim diçka, pa lejen e Tij.” Kështu bënë ata që ishin para tyre. Pra, të Dërguarit a kanë ndonjë detyrim tjetër përveçse ta përçojnë qartë mesazhin?!

وَقَالَ الَّذِينَ أَشْرَكُوا لَوْ شَاءَ اللَّهُ مَا عَبَدْنَا مِنْ دُونِهِ مِنْ شَيْءٍ نَحْنُ وَلَا آبَاؤُنَا وَلَا حَرَمْنَا مِنْ دُونِهِ مِنْ شَيْءٍ كَذَلِكَ فَعَلَ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ فَهَلْ عَلَى الرُّسُلِ إِلَّا الْبَلَاغُ الْمُبِينُ ﴿٢٦﴾

37. Sigurisht, në çdo popull kemi sjellë të dërguar: Adhuroni Allahun dhe ruhuni nga idhujt! Prej tyre ishin që i udhëzoi Allahu, po prej tyre ishin që merituan devijimin. Prandaj, shëtisni nëpër tokë dhe shikoni si ka qenë fundi i mohuesve.

وَلَقَدْ بَعَثْنَا فِي كُلِّ أُمَّةٍ رَسُولًا أَنْ اعْبُدُوا اللَّهَ وَاجْتَنِبُوا الطَّاغُوتَ فَمِنْهُمْ مَنْ هَدَى اللَّهُ وَمِنْهُمْ مَنْ حَقَّتْ عَلَيْهِ الضَّلَالَةُ فَسِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَانظُرُوا كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ الْمُكذِّبِينَ ﴿٢٧﴾

38. Nëse ti je i etur për udhëzimin e tyre, atëherë Allahu nuk i udhëzon ata që devijojnë (të tjerët), dhe ata nuk do të kenë asnjë ndihmës.

إِنْ تَحْرِصْ عَلَى هُدَاهُمْ فَإِنَّ اللَّهَ لَا يَهْدِي مَنْ يُضِلُّ وَمَا لَهُمْ مِنْ نَاصِرِينَ ﴿٢٨﴾

39. Ata u betuan dhe u përbetuan për Allahun: “Allahu nuk ringjall atë

وَأَقْسَمُوا بِاللَّهِ جَهْدَ أَيْمَانِهِمْ لَا يَبْعَثُ اللَّهُ مَنْ يَمُوتُ بَلَى وَعَدًّا عَلَيْهِ حَقًّا

7. Dënimi i një veprë të keqe nuk është një gjë e jashtme, por është pasojë e natyrshme e vetë asaj veprë që është bërë nga njeriu me vullnetin e tij të lirë.

që vdes!” Pse jo?! Është premtim që Ai e ka marrë përsipër, por shumica e njerëzve nuk e dinë.

40. Që Ai t’ua tregojë qartë atë të cilën ata e kundërshtojnë, dhe mohuesit ta dinë se janë gënjeshtarë.

41. Fjala Jonë për diçka që dëshirojmë është vetëm se themi: “Bëhu!”, dhe ajo bëhet.

42. Dhe ata që mërguan për hir të Allahut pasi iu bë mizori, Ne patjetër do t’u sigurojmë mirësi në tokë. Shpërblimi i *ahiretit* është më i madhi. Sikur ta dinin!

43. (Ky shpërblim është për) ata që duruan dhe (që) te Zoti i tyre mbështeten.

44. Ne nuk dërguam përpara teje përveçse burra, të cilëve u shpallëm. Andaj, pyetni zotëruesit e këshillës nëse nuk dini.

45. (I dërguam) me shenjat e qarta dhe shkrime. Dhe ty të zbritëm këshillën, që t’ua shpjegosh qartë njerëzve atë që është zbritur për ta dhe që ata të meditojnë.

46. Atëherë, ata që thurën plane të këqija a janë të sigurt se Allahu nuk do t’i fundosë në tokë ose t’u vijë ndëshkimi prej atje ku ata nuk imagjinojnë?!

وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٤٠﴾

لَيَبَيِّنَنَّ لَهُمْ الَّذِي يَخْتَلِفُونَ فِيهِ وَلَيَعْلَمَنَّ  
الَّذِينَ كَفَرُوا أَنَّهُمْ كَانُوا كَذِبِينَ ﴿٤١﴾

إِنَّمَا قَوْلُنَا لِشَيْءٍ إِذَا أَرَدْنَاهُ أَنْ نَقُولَ  
عَلَيْهِ لَهُ كُنْ فَيَكُونُ ﴿٤٢﴾

وَالَّذِينَ هَاجَرُوا فِي اللَّهِ مِنْ بَعْدِ مَا  
ظَلَمُوا لَنُبَوِّئَنَّهُمْ فِي الدُّنْيَا حَسَنَةً  
وَلَا جَزَاءَ الْآخِرَةِ أَكْبَرَ لَوْ كَانُوا يَعْلَمُونَ ﴿٤٣﴾

الَّذِينَ صَبَرُوا وَعَلَىٰ رَبِّهِمْ يَتَوَكَّلُونَ ﴿٤٤﴾

وَمَا أَرْسَلْنَا مِنْ قَبْلِكَ إِلَّا رَجَالًا  
نُوحِيَ إِلَيْهِمْ فَسَلُّوا أَهْلَ الذِّكْرِ إِنْ  
كُنْتُمْ لَا تَعْلَمُونَ ﴿٤٥﴾

بِالْبَيِّنَاتِ وَالزَّبُرِ ۗ وَأَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الذِّكْرَ  
بِتَمْيِينٍ لِلنَّاسِ مَا نُزِّلَ إِلَيْهِمْ وَلَعَلَّهُمْ  
يَتَفَكَّرُونَ ﴿٤٦﴾

أَفَأَمِنَ الَّذِينَ مَكَرُوا السَّيِّئَاتِ أَنْ يَخْسِفَ  
اللَّهُ بِهِمُ الْأَرْضَ أَوْ يَأْتِيَهُمُ الْعَذَابُ مِنْ  
حَيْثُ لَا يَشْعُرُونَ ﴿٤٧﴾

47. Ose t'i zërë kur ata janë në lëvizje?! Pra, ata nuk mund të mundin (Allahun në punët e Tij).

أَوْ يَأْخُذَهُمْ فِي تَقْلِبِهِمْ فَمَا هُمْ  
بِمُعْجِزِينَ ﴿٤٧﴾

48. Ose t'i kapë duke i pakësuar shkallë-shkallë?! Zoti juaj është shumë i Dhembshur, shumë Mëshirëbërës.

أَوْ يَأْخُذَهُمْ عَلَى تَخَوُّفٍ فَإِنَّ رَبَّكُمْ  
لَرَءُوفٌ رَحِيمٌ ﴿٤٨﴾

49. A nuk kanë parë që çdo gjë që ka krijuar Allahu, hijet e saj ndërrohen nga e djathta në të majtë, duke i bërë sexhde Allahut dhe duke qenë të përlulura?!

أَوَلَمْ يَرَوْا إِلَى مَا خَلَقَ اللَّهُ مِنْ شَيْءٍ  
يَتَتَبَّعُوا ظِلَّهُ عَنِ الْيَمِينِ وَالشَّامِلِ  
سَجْدًا لِلَّهِ وَهُمْ دُخْرُونَ ﴿٤٩﴾

50. Dhe Allahut i bën sexhde ajo që është në qiej dhe ajo që është në tokë nga gjallesat, gjithashtu edhe engjëjt, dhe ata nuk janë mendjemëdhenj.

وَلِلَّهِ يَسْجُدُ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي  
الْأَرْضِ مِنْ دَابَّةٍ وَالْمَلَائِكَةُ وَهُمْ  
لَا يَسْتَكْبِرُونَ ﴿٥٠﴾

51. Frikësohen nga Zoti i tyre që e kanë sipër vetes dhe bëjnë atë për të cilën urdhërohen.

يَخَافُونَ رَبَّهُمْ مِنْ فَوْقِهِمْ وَيَفْعَلُونَ  
مَا يُؤْمَرُونَ ﴿٥١﴾

52. Dhe Allahu tha: Mos merrni dy të adhurueshëm! Vetëm Ai është i Adhurueshmi i Vetëm. Andaj, vetëm prej Meje frikësohuni!

وَقَالَ اللَّهُ لَا تَتَّخِذُوا إِلَهَيْنِ اثْنَيْنِ إِنَّمَا  
هُوَ إِلَهٌ وَاحِدٌ فَإِذَا يَافَوْهُمُ  
فَارْهَبُونِ ﴿٥٢﴾

53. E Atij është ajo që është në qiej dhe tokë. Për Të është bindja e përhershme. A do t'i druheni tjetërkujt përveç Allahut?!

وَلَهُ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَلَهُ الدِّينُ  
وَاصْبِرْ أَفْعَبِرَ اللَّهُ تَتَّقُونَ ﴿٥٣﴾

54. Çdo bekim që keni është prej Allahut. Dhe kur ju prek dhimbja, Atij i përgjëroheni.

وَمَا بِكُمْ مِنْ نِعْمَةٍ فَمِنَ اللَّهِ ثُمَّ إِذَا  
مَسَّكُمُ الضَّرُّ فَأَلَيْهِ تَجْرُونَ ﴿٥٤﴾

55. E kur Ai jua largon dhimbjen, një grup prej jush menjëherë fillojnë t'i atribuojnë ortakë Zotit të tyre.

ثُمَّ إِذَا كَشَفَ الضَّرَّ عَنْكُمْ إِذَا فَرِيقٌ  
مِّنْكُمْ بِرَبِّهِمْ يُشْرِكُونَ ﴿٥٥﴾

56. Që ta mohojnë atë që Ne ua kemi dhënë! Atëherë, përfitoni. Së shpejti do të mësoni!

لِيَكْفُرُوا بِمَا آتَيْنَاهُمْ<sup>ط</sup> فَتَمَتَّعُوا<sup>ق</sup> فَسَوْفَ  
تَعْلَمُونَ<sup>٥٦</sup>

57. Në ato që Ne u kemi dhënë, caktojnë pjesë pa pasur dije për të. “Për Allahun! Do të pyeteni për atë që sajoni.”

وَيَجْعَلُونَ لِمَا لَا يَعْلَمُونَ نَصِيبًا مِّمَّا  
رَزَقْنَاهُمْ<sup>ط</sup> تَاللَّهِ لَتَسْأَلَنَّ عَمَّا كُنْتُمْ  
تَفْتَرُونَ<sup>٥٧</sup>

58. Ata i caktuan bija Allahut! I Shenjtë është Ai! Kurse për vete ata e kanë atë që e pëlqejnë!

وَيَجْعَلُونَ لِلَّهِ الْبَنَاتِ سُبْحَانَهُ<sup>ل</sup> وَلَهُمْ مَا  
يَشْتَهُونَ<sup>٥٨</sup>

59. Kur ndonjërit prej tyre i jepet lajmi i mirë për vajzë, i nxihet fytyra dhe ai mbetet duke e fshehur brengën.

وَإِذَا بُشِّرَ أَحَدُهُمْ بِالْأُنثَىٰ ظَلَّ وَجْهُهُ  
مُسْوَدًّا وَهُوَ كَظِيمٌ<sup>٥٩</sup>

60. Fshihet nga njerëzit për të keqen me të cilën u njoftua. Vallë, a ta mbajë pavarësisht nga poshtërimi apo ta varrosë në dhe?! Ah, sa keq gjykojnë!

يَتَوَارَىٰ مِنَ الْقَوْمِ مِنْ سُوءِ مَا بُشِّرَ بِهِ<sup>ط</sup>  
أَيْمِسُّكَ عَلَىٰ هُونٍ أَمْ يَدُسُّهُ فِي  
الْتُّرَابِ<sup>ط</sup> أَلَا سَاءَ مَا يَحْكُمُونَ<sup>٦٠</sup>

61. Për ata që nuk besojnë në *ahiret* ka shembullin e keq dhe për Allahun është shembulli më i lartë dhe Ai është i Plotfuqishmi, i Urti.

لِلَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ بِالْآخِرَةِ مَثَلُ السَّوِّءِ<sup>ج</sup>  
وَلِلَّهِ الْمَثَلُ الْأَعْلَىٰ<sup>ط</sup> وَهُوَ الْعَزِيزُ  
الْحَكِيمُ<sup>٦١</sup>

62. Nëse Allahu do t'i kapte njerëzit sipas padrejtësisë së tyre, nuk do të linte ndonjë gjallesë në këtë (tokë), por Ai u jep kohë deri në një afat të caktuar. Kështu që, kur do t'u vijë afati i tyre, ata nuk mund të vonohen asnjë çast e as nuk mund ta parakalojnë.

وَلَوْ يُؤَاخِذُ اللَّهُ النَّاسَ بِظُلْمِهِمْ مَا  
تَرَكَ عَلَيْهَا مِنْ دَابَّةٍ<sup>و</sup> وَلَكِنْ يُؤَخِّرُهُمْ  
إِلَىٰ أَجَلٍ مُّسَمًّى<sup>ج</sup> فَإِذَا جَاءَ أَجَلُهُمْ  
لَا يَسْتَخْرُونَ سَاعَةً<sup>و</sup> وَلَا يَسْتَقْدِمُونَ<sup>٦٢</sup>

63. Për Allahun caktojnë atë që vetë nuk e pëlqejnë dhe gjuhët e tyre flasin

وَيَجْعَلُونَ لِلَّهِ مَا يَكْرَهُونَ وَتَصِفُ

gënjeshtrën që për ta është e mira. Pa dyshim, për ta është zjarri dhe (në të) ata do të lëshohen me shpejtësi.

64. Për Allahun! Ne dërguam (të dërguar) te popuj para teje, atëherë djalli ua zbukuroi veprat, andaj, sot ai është (bërë) miku i tyre. Ata do të kenë ndëshkim të dhimbshëm.

65. Ne të zbritëm Librin vetëm që t'ua shpjegosh qartë njerëzve atë në të cilën ata kundërshtojnë dhe (ky Libër të jetë) si udhëzim dhe mëshirë për popullin besimtar.

66. Allahu zbriti prej qiellit ujë, me të cilin e ringjalli tokën pas vdekjes së saj. Sigurisht, në këtë ka shenjë për njerëzit që dëgjojnë.

67. Pa dyshim, edhe në bagëtitë keni shenjë. Jua japim për të pirë atë që ka në barqet e tyre mes bajgës dhe gjakut, (pra), qumësht të pastër, të shijshëm për ata që pinë.

68. Dhe (ju japim për të pirë) prej frutave, të hurmës e të rrushit; ju bëni pije dehëse prej tyre si dhe ushqim të mirë. Sigurisht, në këtë ka shenjë për njerëzit që kuptojnë.

69. Dhe Zoti yt i shpalli bletës: “Bëj shtëpi nëpër male, nëpër pemë dhe në ato (pjergulla) që ngjiten sipër!

أَلَيْسَتْ لَهُمُ الْكُذِبَ أَنَّ لَهُمُ الْحُسْنٰى ط  
لَا جَرَءَ أَنَّ لَهُمُ النَّارَ وَأَنَّهُمْ مُّفْرَطُونَ ﴿٦٤﴾

تَاللّٰهِ لَقَدْ أَرْسَلْنَا إِلَىٰ أُمَمٍ مِّن قَبْلِكَ  
فَزَيْنَ لَهُمُ الشَّيْطٰنُ أَعْمَالَهُمْ فَهُوَ  
وَلِيُّهُمْ الْيَوْمَ وَلَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿٦٥﴾

وَمَا أَنْزَلْنَا عَلَيْكَ الْكِتٰبَ إِلَّا لِتُبَيِّنَ لَهُمُ  
الَّذِي اٰخْتَلَفُوا فِيهِ ۗ وَهُدًى وَرَحْمَةً  
لِّقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ ﴿٦٦﴾

وَاللّٰهُ أَنْزَلَ مِنَ السَّمَآءِ مَآءً فَأَحْيَا بِهِ  
الْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا ۗ إِنَّ فِي ذٰلِكَ  
لَآيَةً لِّقَوْمٍ يَّسْمَعُونَ ﴿٦٧﴾

وَإِنَّ لَكُمْ فِي الْأَنْعَامِ لَعِبْرَةً ۗ نُّسْقِيكُمُ  
مِّمَّا فِي بُطُونِهِمْ مِّن بَيْنِ فَرْثٍ وَ دَمٍ  
لَّبَنًا خَالِصًا يَّسَآئِغًا لِلشَّرِيبِينَ ﴿٦٨﴾

وَمِنْ ثَمَرَاتِ النَّخِيلِ وَالْأَعْنَابِ تَتَّخِذُونَ  
مِنْهُ سَكَرًا وَرِزْقًا حَسَنًا ۗ إِنَّ فِي ذٰلِكَ  
لَآيَةً لِّقَوْمٍ يَعْقِلُونَ ﴿٦٩﴾

وَأَوْحَىٰ رَبُّكَ إِلَى النَّحْلِ أَنِ اتَّخِذِي مِنَ  
الْجِبَالِ بِيُوتًا ۖ وَمِنَ الشَّجَرِ وَمِمَّا  
يَعْرَشُونَ ﴿٧٠﴾

70. Më pas, ha nga çdolloj frute dhe ndiq me bindje rrugët e Zotit tënd.” Nga barqet e tyre del një pije, me ngjyra të ndryshme, në të cilën ka shërim për njerëzit. Vërtet, në këtë ka shenjë për njerëzit që meditojnë.

71. Allahu ju krijoi, më pas do t’ju japë vdekje dhe prej jush ka që kthehet në moshën më të pavlerë (të pleqërisë), që pasi të ketë marrë dije, të mos dijë asgjë. Njëmend, Allahu është i Gjithëdijshëm, i Plotfuqishëm.

72. Allahu u dha begati të bollshme disave prej jush karshi disave të tjerë. Atëherë, ata që kanë bollëkun, nuk ua kthejnë begatitë atyre që i kanë në zotërim, që edhe ata të bëheshin të barabartë në to. Prapë e mohojnë bekimin e Allahut?!<sup>8</sup>

73. Allahu bëri për ju bashkëshortë nga lloji juaj dhe prej bashkëshortëve tuaj bëri për ju djem dhe nipër dhe ju dha nga (ushqimet) e pastra. Atëherë, a do ta besojnë gënjeshtren, kurse bekimin e Allahut do ta mohojnë?!

74. Adhurojnë gjëra të tjera përveç Allahut, që nuk sundojnë për ta asnjë begati në qiej dhe tokë dhe as nuk munden.

75. Pra, mos i bëni shëmbëlltyra Allahut. Njëmend, Allahu di dhe ju nuk dini.

ثُمَّ كُلِي مِنْ كُلِّ الثَّمَرَاتِ فَاسْلُكِي سُبُلَ رَبِّكِ ذُلُلًا يَخْرُجُ مِنْ بُطُونِهَا شَرَابٌ مُخْتَلِفٌ أَلْوَانُهُ فِيهِ شِفَاءٌ لِلنَّاسِ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَةً لِقَوْمٍ يَتَفَكَّرُونَ ﴿٧٠﴾

وَاللَّهُ خَلَقَكُمْ ثُمَّ يَوَفِّقُكُمْ ۖ وَمَنْكُمْ مَنْ يُرَدُّ إِلَىٰ أَرْدَلِ الْعُمُرِ لِكَيْ لَا يَعْلَمَ بَعْدَ عِلْمٍ شَيْئًا ۗ إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ قَدِيرٌ ﴿٧١﴾

وَاللَّهُ فَضَّلَ بَعْضَكُمْ عَلَىٰ بَعْضٍ فِي الرِّزْقِ ۗ فَمَا الَّذِينَ فُضِّلُوا بِرَادِي رِزْقِهِمْ عَلَىٰ مَا مَلَكَتْ أَيْمَانُهُمْ فَهُمْ فِيهِ سَوَاءٌ ۗ أَفَبِعِزَّةِ اللَّهِ يَجْحَدُونَ ﴿٧٢﴾

وَاللَّهُ جَعَلَ لَكُمْ مِنْ أَنْفُسِكُمْ أَزْوَاجًا ۚ وَجَعَلَ لَكُمْ مِنْ أَزْوَاجِكُمْ بَنِينَ وَحَفَدَةً ۚ وَرَزَقَكُمْ مِنَ الطَّيِّبَاتِ ۗ أَقْبَابًا بَاطِلٍ يُؤْمِنُونَ وَبِإِنْعَامِ اللَّهِ هُمْ يَكْفُرُونَ ﴿٧٣﴾

وَيَعْبُدُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ مَا لَا يَمْلِكُ لَهُمْ رِزْقًا مِنَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ شَيْئًا وَلَا يَسْتَطِيعُونَ ﴿٧٤﴾

فَلَا تَصْرِبُوا لِلَّهِ الْأَمْثَالَ ۗ إِنَّ اللَّهَ يَعْلَمُ وَأَنْتُمْ لَا تَعْلَمُونَ ﴿٧٥﴾

8. Lexoni 30:29.

76. Allahu jep shembullin e një robi skllav (që) nuk ka fuqi mbi asgjë dhe të atij që Ne Vetë i kemi dhënë begati të mirë, dhe ai shpenzon prej saj fshehtas dhe haptas. A mund të jenë të barabartë ata?! Lavdia është e Allahut, por shumica e tyre nuk dinë.<sup>9</sup>

77. Dhe Allahu jep shembullin e dy njerëzve, njëri memec (që) nuk ka fuqi mbi asgjë dhe ai është barrë mbi pronarin e vet, kudo që e çon, nuk i sjell mbarësi; a mund të jetë i barabartë ky me atë që urdhëron për drejtësinë dhe (edhe) vetë gjendet në rrugë të drejtë?!<sup>10</sup>

78. E Allahut është e padukshmja e qiejve dhe e tokës. Dhe çështja e Orës është vetëm sa hap e mbyll sytë, madje edhe më afër.<sup>11</sup> Pa dyshim, Allahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë.

79. Dhe Allahu ju nxori nga barqet e nënave tuaja, ju nuk dinit asgjë dhe bëri për ju dëgjimin, shikimin dhe zemrën, që të falënderoni.

صَرَبَ اللَّهُ مَثَلًا عَبْدًا مَمْلُوكًا لَا يَقْدِرُ  
عَلَى شَيْءٍ وَ مَن رَزَقْنَاهُ مِنَّا رِزْقًا حَسَنًا  
فَهُوَ يَنْفِقُ مِنْهُ سِرًّا وَ جَهْرًا هَلْ  
يَسْتَوُونَ الْحَمْدُ لِلَّهِ بَلْ أَكْثَرُهُمْ  
لَا يَعْلَمُونَ ﴿٩﴾

وَ صَرَبَ اللَّهُ مَثَلًا رَجُلَيْنِ أَحَدُهُمَا  
أَبْكَمُ لَا يَقْدِرُ عَلَى شَيْءٍ وَ هُوَ كَلٌّ عَلَى  
مَوْلَاهُ أَيْمَانًا يُوَجِّهُهُ لَا يَأْتِ بِخَيْرٍ هَلْ  
يَسْتَوِي هُوَ وَ مَن يَأْمُرُ بِالْعَدْلِ وَ هُوَ  
يُجِ عَلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ ﴿١٠﴾

وَلِلَّهِ غَيْبُ السَّمَوَاتِ وَ الْأَرْضِ وَ مَا أَمَرَ  
السَّاعَةَ إِلَّا كَلِمَةٍ الْبَصَرِ أَوْ هُوَ أَقْرَبُ  
إِنَّ اللَّهَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿١١﴾

وَ اللَّهُ أَخْرَجَكُمْ مِنْ بُطُونِ أُمَّهَاتِكُمْ لَا  
تَعْلَمُونَ شَيْئًا وَ جَعَلَ لَكُمُ السَّمْعَ  
وَ الْأَبْصَارَ وَ الْأَفْئِدَةَ لَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ ﴿١٢﴾

9. Mohuesi është si ai që ka humbur çdo liri të vullnetit dhe të veprimit dhe është skllav i dëshirave dhe mendimeve të tij të ulëta.

10. Ky dhe ajeti paraardhës, në pjesën e parë të tyre, u referohen dy kategorive të ndryshme të mohuesve. Ajeti i mëparshëm u referohet atyre që janë “në pranga” të besëtytnive, të bindjeve dhe të praktikave të gabuara, megjithëse zotërojnë ende mjete dhe aftësi për të sjellë ndryshimin në veten e tyre, por nuk përfitojnë nga mundësitë për shkak se e kanë zbehur aftësinë e vet të të vepruarit. Kurse ky ajeti u referohet atyre mohuesve të cilët jo vetëm që janë “në pranga” të besëtytnive, por gjithashtu u mungojnë plotësisht mjetet dhe aftësitë për të bërë ndonjë punë pozitive në aspektin shpirtëror.

11. Njëherë duke treguar dy gishtat e dorës, i Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> tha: “Unë dhe Ora jemi dërguar si këta dy (gishta).” (Buhari, nr. 6504).



80. Ata a nuk shohin shpendët të nënshtuar në hapësirën e qiellit?! Askush nuk i mban ata përveç Allahut. Sigurisht, në këtë ka shenja për njerëzit që besojnë.

81. Allahu vuri qetësi për ju në shtëpitë tuaja, dhe bëri shtëpi për ju edhe prej lëkurash të shtazëve, të cilat i gjeni të lehta ditën e nisjes suaj dhe ditën e qëndrimit tuaj. Dhe prej leshit të tyre<sup>12</sup>, prej gëzofit të tyre<sup>13</sup> dhe prej qimeve të tyre<sup>14</sup> bëri shumë pajime e mjete për të përfutuar deri në një kohë të caktuar.

82. Nga ato që krijoi Allahu, Ai bëri për ju gjëra që ju bëjnë hije, bëri për ju streha nëpër male, bëri për ju mbulesat që ju shpëtojnë nga nxehtësia dhe mbulesat që ju shpëtojnë nga lufta. Ai kështu përsos bekimin e Tij mbi ju, që ju të nënshtroheni.

83. E nëse ata e kthejnë shpinën, atëherë ti je i ngarkuar vetëm me kumtimin e qartë të mesazhit.

84. Ata e njohin bekimin e Allahut, (por) sërish e mohojnë, dhe shumica e tyre janë mohues.

أَلَمْ يَرَوْا إِلَى الطَّيْرِ مُسَخَّرَاتٍ فِي جَوِّ السَّمَاءِ ۗ مَا يُمَسِّكُهُنَّ إِلَّا اللَّهُ ۗ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِّقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ ﴿٨٠﴾

وَاللَّهُ جَعَلَ لَكُمْ مِنْ بُيُوتِكُمْ سَكَنًا وَجَعَلَ لَكُمْ مِنْ جُلُودِ الْأَنْعَامِ بُيُوتًا تَسْتَخِفُّونَهَا يَوْمَ ظَعْنِكُمْ وَيَوْمَ إِقَامَتِكُمْ ۗ وَمِنْ أَصْوَابِهَا وَأَوْبَارِهَا وَأَشْعَارِهَا أَثَانًا وَمَتَاعًا إِلَىٰ حِينٍ ﴿٨١﴾

وَاللَّهُ جَعَلَ لَكُمْ مِمَّا خَلَقَ ظِلَالًا وَجَعَلَ لَكُمْ مِنَ الْجِبَالِ أَكْنَانًا وَجَعَلَ لَكُمْ سَرَابِيلَ تَقِيكُمُ الْحَرَّ وَسَرَابِيلَ تَقِيكُمُ بَأْسَكُمْ ۗ كَذَلِكَ يُتِمُّ نِعْمَتَهُ عَلَيْكُمْ لَعَلَّكُمْ تُسَلِّمُونَ ﴿٨٢﴾

فَإِنْ تَوَلَّوْا فَإِنَّمَا عَلَيْكَ الْبَلْغُ الْمُبِينُ ﴿٨٣﴾

يَعْرِفُونَ نِعْمَتَ اللَّهِ ثُمَّ يُنْكِرُونَهَا ۗ وَأَكْثَرُهُمُ الْكٰفِرُونَ ﴿٨٤﴾

12. Të deleve.

13. Të devesë

14. Të dhive.

85. Ditën kur do të ngremë një dëshmitar nga çdo popull, atëherë atyre që mohuan nuk do t'u lejohet (të thonë diçka) dhe ata as nuk do të mund të kërkojnë falje.

86. Kur ta shohin ndëshkimin ata që bënë keq, ai (ndëshkim) nuk do t'u pakësohet, dhe nuk do t'u jepet as lëshim.

87. Dhe ata që i bënë ortakë Zotit, kur të shohin zotat e tyre, do të thonë: "O Zoti ynë! Këta janë zotat tanë që ne u luteshim përveç Teje!" Atëherë, ata do t'ua kthejnë fjalën: "Ju përnjëmend jeni gënjeshhtarë!"

88. Atë ditë ata do të paraqesin nënshtrimin ndaj Allahut dhe do t'u humbet gjithçka që trillonin.

89. Atyre që mohuan dhe penguan nga rruga e Allahut, Ne do t'u shtojmë ndëshkim pas ndëshkimi për shkak të trazirës që bënë.

90. Dhe ditën kur do të ngremë nga çdo popull nga gjiri i tyre një dëshmitar mbi ta dhe ty do të të sjellim dëshmitar mbi (të gjithë) ata. Ty të kemi zbritur Librin si shpjegues të çdo gjëje, udhëzim, mëshirë dhe lajm të mirë për të nënshtruarit.

91. Sigurisht, Allahu urdhëron drejtësinë, mirësinë dhe dhembshurinë si ajo që u tregohet të afërmve, si dhe ndalon imoralitetin,

وَيَوْمَ نَبْعَثُ مِنْ كُلِّ أُمَّةٍ شَهِيدًا ثُمَّ لَا يُؤَدُّنَ لِلَّذِينَ كَفَرُوا وَلَا هُمْ يُسْتَعْتَبُونَ ﴿٨٥﴾

وَإِذَا رَأَى الَّذِينَ ظَلَمُوا الْعَذَابَ فَلَا يُخَفِّفُ عَنْهُمْ وَلَا هُمْ يُنظَرُونَ ﴿٨٦﴾

وَإِذَا رَأَى الَّذِينَ أَشْرَكُوا شُرَكَاءَهُمْ قَالُوا رَبَّنَا هَؤُلَاءِ شُرَكَائُنَا الَّذِينَ كُنَّا نَدْعُوا مِنْ دُونِكَ ۖ فَأَلْقُوا إِلَيْهِمُ الْقَوْلَ إِنَّكُمْ لَكَاذِبُونَ ﴿٨٧﴾

وَأَلْقُوا إِلَى اللَّهِ يَوْمَئِذٍ السَّلَمَ وَصَلَ عَنْهُمْ مَا كَانُوا يَفْتَرُونَ ﴿٨٨﴾

الَّذِينَ كَفَرُوا وَصَدُّوا عَنْ سَبِيلِ اللَّهِ زِدْنَاهُمْ عَذَابًا فَوْقَ الْعَذَابِ بِمَا كَانُوا يُفْسِدُونَ ﴿٨٩﴾

وَيَوْمَ نَبْعَثُ فِي كُلِّ أُمَّةٍ شَهِيدًا عَلَيْهِمْ مِنْ أَنْفُسِهِمْ وَجِئْنَا بِكَ شَهِيدًا عَلَى هَؤُلَاءِ ۗ وَنَزَّلْنَا عَلَيْكَ الْكِتَابَ تِبْيَانًا لِكُلِّ شَيْءٍ ۖ وَهُدًى وَرَحْمَةً وَبُشْرَى لِلْمُسْلِمِينَ ﴿٩٠﴾

إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُ بِالْعَدْلِ وَالْإِحْسَانِ وَإِيتَاءِ ذِي الْقُرْبَىٰ وَيَنْهَىٰ عَنِ الْمُنْكَرِ

veprat e shëmtuara dhe dhunën. Ai ju këshillon, në mënyrë që ju të reflektoni.<sup>15</sup>

92. Dhe plotësoni premtimin e Allahut kur të premtoni. Mos i thyeni premtimet pas betimit, ndërkohë ju e keni bërë Allahun Dorëzanë për vete. Njëmend, Allahu e di atë që bëni.

93. Mos u bëni si ajo grua që prishi tjerren e vet duke e bërë copë-copë, pasi ajo ishte bërë e fortë. Ju përdorni betimet tuaja për mashtrim mes njëri-tjetrit (nga frika) se mos një grup (tjetër) shtohet më shumë se grupi (juaj). Në të vërtetë, Allahu ju sprovon me anë të kësaj dhe Ai

وَالْبَعْثِ ۚ يَعْظُمُ لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ ﴿١٥﴾

وَأَوْفُوا بِعَهْدِ اللَّهِ إِذَا عَاهَدْتُمْ وَلَا تَتَّقُوا  
الْأَيْمَانَ بَعْدَ تَوْكِيدِهَا وَقَدْ جَعَلْتُمُ اللَّهَ  
عَلَيْكُمْ كَفِيلًا ۗ إِنَّ اللَّهَ يُعَلِّمُ مَا تَفْعَلُونَ ﴿١٦﴾

وَلَا تَكُونُوا كَالَّذِي تَقَصَّتْ عَرْلَهَا مِنْ  
بَعْدِ قُوَّةٍ أَنْكَاثًا ۗ تَتَّخِذُونَ أَيْمَانَكُمْ دَخَلًا  
بَيْنَكُمْ أَنْ تَكُونَ أُمَّةٌ هِيَ أَرْبُ مِنْ أُمَّةٍ ۗ  
إِنَّمَا يَبْلُوكُمُ اللَّهُ بِهِ ۗ وَلِيُبَيِّنَ لَكُمْ يَوْمَ

15. Ky ajet përmban tri urdhëresa dhe tri ndalesa, të cilat trajtojnë shkurtimisht të gjitha fazat e zhvillimit moral dhe shpirtëror të njeriut, si në aspektin pozitiv, ashtu edhe në atë negativ. Ndër urdhëresat, drejtësia është shkalla e parë e që nënkupton që njeriu duhet t'i trajtojë të tjerët me drejtësi, siç ai dëshiron të trajtohet prej të tjerëve. Nderin ta lajë me nder dhe mirësinë me mirësi. Shkalla e dytë është ajo e mirësisë (arab. *ihsan*), pra, t'u bëjë mirësi të tjerëve, pavarësisht nga sjellja që ata kanë ndaj tij. Por Kurani nuk ndalon këtu. Ai të nxit të arrish edhe shkallën e tretë, të kesh dhembshurinë si ajo që u tregohet të afërmve. Nëse në shkallën e dytë, njeriu pret ndonjë falënderim për mirësinë që i bën tjetrit, në këtë shkallë, ai bëhet tërësisht vetëmohues, ushqen dashurinë amënore për të tjerët, pra si një nënë që ka dhembshuri ndaj fëmijës, që nuk pret asnjë falënderim prej fëmijës. Atëherë mirësia bëhet pjesë e qenësishme e besimtarit. Ky është kulmi i zhvillimit moral për të. Këto tri faza përbëjnë anën pozitive të zhvillimit moral të njeriut. Pjesa e dytë e ajetit e ndalon njeriun nga tri anët negative, që i rendit nga më pak e dëmshmjia deri te më e dëmshmjia. Fjala arabe *fahsha* nënkupton imoralitetin, ligësinë e fshehur, e cila i sjell dëm vepruesit. Fjala *munker* nënkupton ato të këqija që edhe njerëzit e tjerë mund t'i shohin, i cilësojnë si të shëmtuara dhe i dënojnë, edhe pse ata vetë nuk pësojnë humbje të madhe prej tyre. Kurse dhuna është shkalla më e lartë e ligësisë, me të cilën vepruesi u shkakton dëm dhe dhimbje edhe të tjerëve. Kështu këto tri fjalë të thjeshta mbulojnë ligësinë dhe të keqen në të gjitha format e saj. Në këtë mënyrë, ky ajet përbën gjithë planin mësimor të përsosmërisë shpirtërore, me ndjekjen e të cilit, njeriu mund të arrijë në nivelin e shtatë, ku zhvillimi i tij përsoset. Njerëzit që janë të zhytur në lllumin e ligësive të kategorisë *dhunë*, duke u munduar kalojnë në baltën e veprës së shëmtuar. Pastaj nga atje, nëse përpiqen mund të dalin për të kaluar në pluhurat e imoraliteteve. Kur pastrohen edhe nga ato, do të gjenden në stepën e drejtësisë. Kur ecin më lart, dalin në lëndinën e mirësisë dhe, nëse përparojnë akoma më shumë, do të mbërrijnë në mirësinë amënore, në një kopsht ku rrjedhin lumenj e burime. Më tej shtrihet vetëm xheneti.

patjetër do t'ju tregojë qartë Ditën e Kiametit atë që kundërshtonit.

94. Po të donte Allahu, do t'ju bënte një popull të vetëm, por Ai e cilëson të devijuar kë të dojë dhe udhëzon kë të dojë. Dhe ju patjetër do të pyeteni për atë që bënit.

95. Mos përdorni betimet tuaja për mashtrim mes njëri-tjetrit, që të mos rrëshqisni pasi ta keni vendosur hapin dhe ju ta shijoni të keqen, për shkak se pengoni nga rruga e Allahut dhe, (më pas), të keni ndëshkim të madh.

96. Mos shitni premtimin e Allahut për një vlerë të vogël. Njëmend, ajo që është tek Allahu është më e mirë për ju, në qoftë se dini.

97. Ajo që keni ju, do të soset dhe ajo që është tek Allahu, do të mbetet. Ne me siguri do t'u japim atyre që duruan shpërblimin e tyre, sipas më të mirës së asaj që ata bënin.

98. Kushdo që bën vepër të mirë, qoftë mashkull a femër, dhe është besimtar, Ne me siguri do ta ringjallim atë në formën e një jete të pastër; dhe këtyre do t'ua japim shpërblimin e tyre sipas më të mirës së asaj që ata bënin.<sup>16</sup>

الْقِيَامَةِ مَا كُنْتُمْ فِيهِ تَحْتَمُونَ ﴿١٦﴾

وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ لَجَعَلَكُمْ أُمَّةً وَاحِدَةً  
وَلَكِنْ يُضِلُّ مَنْ يَشَاءُ وَيَهْدِي مَنْ يَشَاءُ  
وَلَتُسْأَلُنَّ عَمَّا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ ﴿١٧﴾

وَلَا تَتَّخِذُوا أَيْمَانَكُمْ دَحَلًا بَيْنَكُمْ  
فَتَزِيلَ أقدامَ بَعْدَ ثُبُوتِهَا وَتَذُوقُوا  
السُّوَاءَ بِمَا صَدَدْتُمْ عَنْ سَبِيلِ اللَّهِ  
وَلَكُمْ عَذَابٌ عَظِيمٌ ﴿١٨﴾

وَلَا تَسْتُرُوا بِعَهْدِ اللَّهِ إِيمَانًا عِنْدَ  
اللَّهِ هُوَ خَيْرٌ لَكُمْ إِنْ كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ ﴿١٩﴾

مَا عِنْدَكُمْ يَنْفَدُ وَمَا عِنْدَ اللَّهِ بَاقٍ  
وَلَنَجْزِيَنَ الَّذِينَ صَبَرُوا أَجْرَهُمْ  
بِأَحْسَنِ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿٢٠﴾

مَنْ عَمِلَ صَالِحًا مِّنْ ذَكَرٍ أَوْ أُنْثَىٰ وَهُوَ  
مُؤْمِنٌ فَلَنُحْيِيَنَّهُ حَيَاةً طَيِّبَةً  
وَلَنَجْزِيَنَّهُمْ أَجْرَهُمْ بِأَحْسَنِ مَا كَانُوا  
يَعْمَلُونَ ﴿٢١﴾

16. Ajeti vendos barazinë e të drejtave të burrave dhe të grave dhe u premtim të dyve pjesë të barabartë në mirësitë Hyjnore. Lexoni edhe 33:36.

99. Kur lexon Kuranin, kërkoji mbrojtjen Allahut nga djalli i mallkuar.

فَإِذَا قَرَأْتَ الْقُرْآنَ فَاسْتَعِذْ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ ﴿٩٩﴾

100. Sigurisht, ai nuk ka pushtet mbi ata që besuan dhe (që) mbështeten te Zoti i tyre.

إِنَّهُ لَيْسَ لَهُ سُلْطَانٌ عَلَى الَّذِينَ آمَنُوا وَعَلَى رَبِّهِمْ يَتَوَكَّلُونَ ﴿١٠٠﴾

101. Pushteti i tij është vetëm mbi ata që e bëjnë mik dhe i bëjnë ortakë (Allahut).

إِنَّمَا سُلْطَانُهُ عَلَى الَّذِينَ يَتَوَلَّوْنَهُ وَالَّذِينَ هُمْ بِهِ مُشْرِكُونَ ﴿١٠١﴾

102. Dhe kur ndërrojmë një ajet me një ajet tjetër, dhe Allahu e di më së miri se çfarë dërgon, ata thonë: “Me siguri ti je trillues”. Përkundrazi, shumica e tyre nuk dinë.<sup>17</sup>

وَإِذَا بَدَّلْنَا آيَةً مَكَانَ آيَةٍ وَاللَّهُ أَعْلَمُ بِمَا يُنزِّلُ قَالُوا إِنَّمَا أَنْتَ مُفْتَرٍ ۗ بَلْ أَكْثَرُهُمْ لَا يَعْلَمُونَ ﴿١٠٢﴾

103. Thuaj: Atë e zbriti Shpirti i shenjtë prej Zotit tënd me vërtetësi, që t’u japë qëndrueshmëri atyre që besuan dhe të jetë udhëzim e lajm i mirë për të nënshtruarit.

قُلْ نَزَّلَهُ رُوحُ الْقُدُسِ مِنْ رَبِّكَ بِالْحَقِّ لِيُثَبِّتَ الَّذِينَ آمَنُوا وَهُدًى وَبُشْرَىٰ لِلْمُسْلِمِينَ ﴿١٠٣﴾

104. Sigurisht, Ne e dimë që ata thonë: “atë e mëson një njeri”. Gjuha e atij të cilit ata i referohen është joarabe (joelokuente), kurse kjo (gjuha e Kuranit) është një gjuhë e qartë arabe.

وَلَقَدْ نَعْلَمُ أَنَّهُمْ يَقُولُونَ إِنَّمَا يُعَلِّمُهُ بَشَرٌ ۗ لِسَانُ الَّذِي يُلْحِدُونَ إِلَيْهِ أَعْجَبُ ۗ وَهَذَا لِسَانٌ عَرَبِيٌّ مُبِينٌ ﴿١٠٤﴾

17. Këtu fjala “ajet” (që do të thotë *shenjë*) nuk u referohet ajeteve të Kuranit, pasi ato nuk kanë ndryshuar asnjëherë, por siç kemi shpjeguar edhe në komentin e ajetit 107 të sures El-Bekare, bëhet fjalë për zëvendësimin e shpalljeve ose të porosive Hyjnore të Librave të mëparshëm me shpalljet e Kuranit. Sa herë që një Sheriat i mëparshëm u shfuqizua apo u la në harresë, Zoti i Madhërishtëm dërgoi një të ngjashëm me të ose edhe më të mirë se ai. Kështu ndodhi edhe me zbritjen e Kuranit të Shenjtë, Libri përfundimtar, i cili i shfuqizoi shpalljet e mëparshme që nuk u jepnin më qëndrueshmëri, udhëzim dhe lajmin e mirë besimtarëve të tyre. Një kuptim tjetër i këtij ajeti është që sa herë që Zoti vononte një ndëshkim të paralajmëruar, ose e zëvendësonte atë me një shenjë tjetër, kjo për efekt përmirësimi te njerëzit që janë paralajmëruar, mohuesit mekas thoshin – Ti je gënjeshtar.

105. Njëmend, ata që nuk besojnë ajetet e Allahut, Allahu nuk do t'i udhëzojë dhe ata do të kenë ndëshkim të dhimbshëm.

106. Gënjeshtrenë e sajojnë vetëm ata të cilët nuk besojnë në ajetet e Allahut. Pikërisht këta janë gënjeshtarë.

107. Ai që mohoi Allahun pas besimit të tij, me përjashtim të atij që iu imponua, ndërkohë zemra e tij është qetësuar me besim, kurse ata që mohuan me gjithë zemër, do të kenë zemërimin e Allahut. Dhe për ta do të ketë ndëshkim të madh.

108. Kjo sepse ata u dashuruan me jetën e kësaj bote, karshi *ahiretit*. Sigurisht, Allahu nuk udhëzon popullin mohues.

109. Pikërisht këtyre Allahu ua vulosi zemrat, veshët dhe sytë. Pikërisht këta janë të shkujdesurit.

110. Nuk ka dyshim, këta do të jenë humbësit në *ahiret*.

111. Zoti yt për ata që mërguan pasi u vunë në sprovë, më pas luftuan dhe duruan, sigurisht se Zoti yt pas këtyre është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

112. Ditën kur çdo shpirt do të vijë duke u grindur për vete dhe do t'i jepet plotësisht secilit shpirt ajo që

إِنَّ الَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ بِآيَاتِ اللَّهِ لَا يَهْدِيهِمُ اللَّهُ وَلَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿١٠٥﴾

إِنَّمَا يَفْتَرِي الْكُذِبَ الَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ بِآيَاتِ اللَّهِ ۗ وَأُولَٰئِكَ هُمُ الْكٰذِبُونَ ﴿١٠٦﴾

مَنْ كَفَرَ بِاللَّهِ مِنْ بَعْدِ إِيمَانِهِ إِلَّا مَنْ أَكْرَهَ وَقَلْبُهُ مُطْمَئِنٌّ بِالْإِيمَانِ وَلَكِنْ مَنْ شَرَحَ بِالْكُفْرِ صَدْرًا فَعَلَيْهِمْ غَضَبٌ مِنَ اللَّهِ ۗ وَلَهُمْ عَذَابٌ عَظِيمٌ ﴿١٠٧﴾

ذٰلِكَ بِأَنَّهُمْ اسْتَحَبُّوا الْحَيٰوةَ الدُّنْيَا عَلَى الْآخِرَةِ ۗ وَإِنَّ اللَّهَ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الْكٰفِرِيْنَ ﴿١٠٨﴾

أُولَٰئِكَ الَّذِينَ طَبَعَ اللَّهُ عَلَىٰ قُلُوبِهِمْ وَسَمِعَهُمْ وَأَبْصَارِهِمْ ۗ وَأُولَٰئِكَ هُمُ الْغٰفِلُونَ ﴿١٠٩﴾

لَا جَرَمَ لَهُمْ فِي الْآخِرَةِ ۗ هُمُ الْخٰسِرُونَ ﴿١١٠﴾

ثُمَّ إِنَّ رَبَّكَ لِلَّذِينَ هَاجَرُوا مِنْ بَعْدِ مَا قَاتَلُوا ثُمَّ جَاهَدُوا وَصَبَرُوا ۗ إِنَّ رَبَّكَ بِعَمَلِهِمْ لَخَبِيرٌ ﴿١١١﴾

يَوْمَ تَأْتِي كُلُّ نَفْسٍ تُجَادِلُ عَنْ نَفْسِهَا وَتُوَفَّىٰ كُلُّ نَفْسٍ مَّا عَمِلَتْ وَهُمْ

ka punuar. Atyre nuk do t'u bëhet padrejtësi.

لَا يُظْلَمُونَ ﴿١٣﴾

113. Allahu dha shembullin e një fshati që ishte i sigurt dhe i qetë, të cilit i vinte furnizimi lirshëm nga çdo anë. Ai u bë mosmirënjohës ndaj bekimeve të Allahut, atëherë Allahu i veshi petkun e urisë dhe të frikës, për shkak të asaj që ata (banorë) bënin.

وَصَرَبَ اللَّهُ مَثَلًا قَرْيَةً كَانَتْ آمِنَةً  
مُطْمَئِنَّةً يَأْتِيهَا رِزْقُهَا رَغَدًا مِنْ كُلِّ  
مَكَانٍ فَكَفَرَتْ بِأَنْعَمِ اللَّهِ فَأَذَاقَهَا  
اللَّهُ لِبَاسَ الْجُوعِ وَالْخَوْفِ بِمَا كَانُوا  
يَصْنَعُونَ ﴿١٣﴾

114. Dhe sigurisht, atyre u ka ardhur një i Dërguar nga gjiri i tyre dhe ata e quajtën gënjeshtar, atëherë i zuri ndëshkimi në kohën kur ata ishin keqbërës.

وَلَقَدْ جَاءَهُمْ رَسُولٌ مِنْهُمْ فَكَذَّبُوهُ  
فَأَخَذَهُمُ الْعَذَابُ وَهُمْ ظَالِمُونَ ﴿١٤﴾

115. Hani të lejuarat (dhe) të pastrat nga ajo që Allahu ju ka dhënë dhe falënderoni për bekimin e Allahut, nëse vetëm Atë e adhuron.

فَكُونُوا مِمَّا رَزَقَكُمْ اللَّهُ حَلَالًا طَيِّبًا  
وَأَشْكُرُوا نِعْمَتَ اللَّهِ إِنْ كُنْتُمْ إِيَّاهُ  
تَعْبُدُونَ ﴿١٥﴾

116. Sigurisht, Ai ju ka ndaluar vetëm ngordhësirën, gjakun, mishin e derrat dhe atë për të cilën i është lutur dikujt tjetër përveç Allahut. Por ai që detyrohet tej mase dhe që nuk është as lakmues e as shkelës i kufijve, Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

إِنَّمَا حَرَّمَ عَلَيْكُمُ الْمَيْتَةَ وَالْدَّمَ وَلَحْمَ  
الْخِنْزِيرِ وَمَا أَهَلَ لِغَيْرِ اللَّهِ بِهِ ۚ فَمَنْ  
اضْطُرَّ غَيْرَ بَاغٍ وَ لَا عَادٍ فَإِنَّ اللَّهَ  
غَفُورٌ رَحِيمٌ ﴿١٦﴾

117. Dhe për ato (gjëra) që gjuhët tuaja përshkruajnë gënjeshtër, mos thoni se kjo është e lejuar dhe kjo është e ndaluar, sepse kështu ju trilloni gënjeshtër mbi Allahun. Pa dyshim, ata që trillojnë ndonjë gënjeshtër mbi Allahun, nuk do të kenë sukses.

وَلَا تَقُولُوا لِمَا تَصِفُ أَلْسِنَتُكُمُ الْكَذِبَ  
هَذَا حَلَالٌ وَ هَذَا حَرَامٌ لِيُفْتَرُوا عَلَى  
اللَّهِ الْكَذِبَ ۗ إِنَّ الَّذِينَ يَفْتَرُونَ عَلَى  
اللَّهِ الْكَذِبَ لَا يُفْلِحُونَ ﴿١٧﴾

118. Do të kenë një përfitim të vogël dhe (më pas) ndëshkim të dhimbshëm.

مَتَاعٌ قَلِيلٌ ۖ وَلَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿١١٨﴾

119. Edhe për hebrenjtë i ndaluan ato që të përmendëm më parë. Nuk u bëmë keq Ne atyre, por ata vetvetes i bënë keq.

وَعَلَى الَّذِينَ هَادُوا حَرَمْنَا مَا كَصَحْنَا  
عَلَيْكَ مِنْ قَبْلُ ۗ وَمَا ظَلَمْنَاهُمْ وَلَكِنْ  
كَانُوا أَنْفُسَهُمْ يَظْلِمُونَ ﴿١١٩﴾

120. Sërish, Zoti yt (ishte) për ata që bënë keq nga padija dhe më pas u penduan dhe u përmirësuan; pas këtij (ndryshimi), njëmend Zoti yt është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

ثُمَّ إِنَّ رَبَّكَ لِلَّذِينَ عَمِلُوا السُّوءَ  
بِجَهَالَةٍ ثُمَّ تَابُوا مِنْ بَعْدِ ذَلِكَ وَأَصْلَحُوا  
﴿١٢٠﴾ إِنَّ رَبَّكَ مِنْ بَعْدِهَا لَعَفُورٌ رَحِيمٌ ﴿١٢١﴾

121. Pa dyshim, Ibrahimisihte (sa) një popull, i nënshtuar, gjithnjë i anuar ndaj Allahut dhe nuk ishte prej idhujtarëve;

إِنَّ إِبْرَاهِيمَ كَانَ أُمَّةً قَانِتًا لِلَّهِ حَنِيفًا  
وَلَمْ يَكُ مِنَ الْمُشْرِكِينَ ﴿١٢١﴾

122. falënderues për bekimet e Tij. (Allahu) e zgjodhi atë dhe e përudhi drejt rrugës së drejtë.

شَاكِرًا لِأَنْعَمِهِ ۗ اجْتَبَاهُ وَهَدَاهُ إِلَى  
صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ ﴿١٢٢﴾

123. Dhe atij i dhamë të mirën në këtë botë dhe sigurisht, në *ahiret* ai do të jetë ndër të dëlirët.

وَأَتَيْنَاهُ فِي الدُّنْيَا حَسَنَةً ۗ وَإِنَّهُ فِي  
الْآخِرَةِ لَمِنَ الصَّالِحِينَ ﴿١٢٣﴾

124. Pastaj ty të shpallëm: Ndiq popullin e Ibrahimit të nënshtuar dhe ai nuk ishte prej idhujtarëve.

ثُمَّ أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ أَنْ اتَّبِعْ مِلَّةَ إِبْرَاهِيمَ  
حَنِيفًا ۗ وَمَا كَانَ مِنَ الْمُشْرِكِينَ ﴿١٢٤﴾

125. Njëmend, *sabati* iu vu (si sprovë) atyre që kundërshtuan në lidhje me të. Dhe Zoti yt do të gjykojë mes tyre Ditën e Kiametit për atë që ata kundërshtonin.

إِنَّمَا جَعَلَ السَّبْتُ عَلَى الَّذِينَ اخْتَلَفُوا  
فِيهِ ۗ وَإِنَّ رَبَّكَ لَيَحْكُمُ بَيْنَهُمْ يَوْمَ  
الْقِيَامَةِ فِيمَا كَانُوا فِيهِ يَخْتَلِفُونَ ﴿١٢٥﴾



126. Thirr drejt rrugës së Zotit tënd me urtësi<sup>18</sup> dhe këshillë të mirë dhe argumentojua në atë mënyrë që është më e mira. Sigurisht, është Zoti yt Ai që di më së miri atë që devijoi nga rruga e Tij dhe po Ai i di më së miri ata që janë të udhëzuar.

أَدْعُ إِلَى سَبِيلِ رَبِّكَ بِالْحُكْمَةِ وَالْمَوْعِظَةِ  
الْحَسَنَةِ وَجَادِلْهُمْ بِالَّتِي هِيَ أَحْسَنُ<sup>ط</sup>  
إِنَّ رَبَّكَ هُوَ أَعْلَمُ بِمَنْ ضَلَّ عَنْ  
سَبِيلِهِ وَهُوَ أَعْلَمُ بِالْمُهْتَدِينَ<sup>١٦</sup>

127. Nëse ndëshkoni, ndëshkoni aq sa ju jeni ndëshkuar, dhe po të duroni, kjo është më mirë për durimtarët.

وَإِنْ عَاقَبْتُمْ فَعَاقِبُوا بِمِثْلِ مَا عُوقِبْتُمْ  
بِهِ<sup>ط</sup> وَلَئِنْ صَبَرْتُمْ لَهُوَ خَيْرٌ لِلصَّابِرِينَ<sup>١٧</sup>

128. Duro, dhe durimi yt është vetëm për Allahun, mos u brengos për ata dhe mos u ngushto për shkak të asaj që ata intrigojnë.

وَاصْبِرْ وَمَا صَبْرُكَ إِلَّا بِاللَّهِ وَلَا تَحْزَنْ  
عَلَيْهِمْ وَلَا تَكُ فِي صَيْقِلٍ مِّمَّا يَمْكُرُونَ<sup>١٨</sup>

129. Njëmend, Allahu është me ata që kanë drojë (Atë) dhe që janë mirëbërës.

إِنَّ اللَّهَ مَعَ الَّذِينَ اتَّقَوْا وَالَّذِينَ هُمْ  
مُحْسِنُونَ<sup>١٩</sup>

18. Fjala arabe *hikmet* (urtësi) do të thotë: (1) dituri, shkencë; (2) barazi, drejtësi; (3) durim, mëshirë; (4) qëndrueshmëri; (5) çdo thënie a fjalë që përputhet me të vërtetën dhe përputhet edhe me kërkesat e rastit; (6) dhurata e profetërisë dhe (7) ajo që e frenon njeriun nga paudhësia (Lane).

## Surja 17 – Beni Israil

Surja Beni Israil është mekase dhe bashkë me *bismil-lahin* ka njëqind e dymbëdhjetë ajete. Kjo sure gjithashtu quhet El-Isra.

Tema e ngritjes shpirtërore të Profetit Muhammed<sup>savs</sup> që ishte përmendur në suren paraardhëse, vijon edhe këtu. Këtu thuhet që misioni i Profetit Muhammed<sup>savs</sup> nuk mbaron deri në Palestinë, atje ku e përfunduan misionin Profetët e tjerë, por prej atje ngrihet në lartësi të reja. Kështu që, përmendet edhe *Hazret Musai<sup>as</sup>* dhe profetësia e tij, por duke shpjeguar që pavarësisht se edhe ai pati ngritje shumë të lartë shpirtërore, Profeti Muhammed<sup>savs</sup> ngritjen shpirtërore do ta kishte akoma më shumë.

Kjo sure përmend hebrenjtë në një mënyrë tjetër. Ata ishin dëbuar nga Palestina, nga vendi i tyre, për shkak të krimeve që kishin bërë. Zoti i Madhërishëm caktoi disa njerëz të ashpër mbi ta, të cilët hynë në qytetin e tyre dhe e rrëzuan atë furishëm. Por Allahu i Madhërishëm do t'i mëshironte ata dhe do t'u jepte një mundësi që ata ta zotëronin Palestinën edhe një herë. Kjo profeci u përmbush në kohët tona. Por thuhet gjithashtu që nëse ata nuk do të pendohen dhe nëse nuk do të kenë mëshirë për robërit e Allahut, Zoti i Madhërishëm sërish do t'i dëbojë nga Palestina, por jo në mënyrë luftarake me muslimanët, dhe më pas robërit e Tij të sinqertë do t'i bëjë trashëgimtarët e saj. Kjo tregon që muslimanët nuk do ta sundojnë dot Palestinën, derisa nuk do ta përmbushin kushtin duke u bërë robër të sinqertë të Zotit.

Më pas flitet për ligësitë të cilat ishin bërë pjesë e jetës së hebrenjve në kohën kur atyre iu ishin ngurtësuar zemrat, pra për ligësitë si koprracia, ekstravaganca, kurvëria, vrasja, zhvatja e pasurisë së jetimit, shkelja e premtiveve, mburrja, etj., dhe muslimanëve u është tërhequr vëmendja që të ruhen nga ato.

Më pas thuhet: Kur ti reciton këtë Kuran madhështor, ata nuk arrijnë ta kuptojnë dhe kaq shumë janë të zhytur në idhujtari, sa që kur u flet për njëshmërinë e Zotit, ata ikin duke ta kthyer shpinën. Atyre nuk u intereson kredoja (*kelimah*) e njëshmërisë së Zotit. Dhe ngaqë mosbesimi ka zënë vend në zemrat e tyre, ata e mohojnë tërësisht edhe botën tjetër. Dhe populli që nuk beson në botën e përtejme dhe që nuk beson se atij do t'i kërkohet llogari për veprat e veta, përparon pareshtur në ligësi dhe mëkate.

Më pas, përmendet sërish udhëtimi shpirtëror i Profetit Muhammed<sup>savs</sup> në të cilin atij iu tregua Palestina dhe ai u bekua me lartësi të mëtejshme shpirtërore dhe në këtë kontekst flitet për pemën e mallkuar, e cila si duket këtu u referohet atyre hebrenjve që u përmendën në ajetin e fundit të sures El-Fatiha. Pra, thuhet që ata gjithmonë do të jenë nën zemërimin, edhe të Allahut edhe të njerëzve.

Pas pemës së mallkuar, kjo sure flet për *Hazret Ademin<sup>as</sup>* dhe për *Iblisin* (djallin) dhe se si ata u krijuan: i pari prej dheut dhe i dyti prej zjarrit. Njerëzit që shpesh kalojnë në procesin e zemërimit dhe të hakmarrjes, i përngajnë zjarrit, i cili djeg çdo mbjell-

je e lulëzim. Kurse ata që janë të përlurur, i përngajnë dheut, i cili mundëson çdolloj mbjelljeje dhe lulëzimi. Kjo temë në këtë kontekst duket se tregon që hebrejtë gjithnjë do të jenë të angazhuar për të shkatërruar përpjekjet konstruktive të Profetit Muhammed<sup>savs</sup> dhe do të mëtojnë se ata që janë rritur përmes dheut, nuk mund t'u bëjnë dot ballë atyre që janë rritur përmes zjarrit. Por ata harrojnë se e gjithë natyra e lulëzuar në botë është dëshmitare se zjarri nuk e asgjëson dot atë, pasi edhe ajo është krijuar dhe mbështetur nga Zoti i Madhërishëm.

Pas kësaj janë ajetet që fillojnë me porosinë: “Lartëso namazin”, dhe ku përmendet edhe pozita e lartë dhe e lavdëruar e Profetit Muhammed<sup>savs</sup> “*mekam mahmud*”. Pra, ka një mesazh për kundërshtarët e tij: Përpiquni sa të doni për ta njosur Profetin Muhammed<sup>savs</sup>, Zoti i Madhërishëm çdo herë do ta ngrejë atë akoma më lart në pozitën e lavdëruar. Kështu që, Zoti e ka çuar Profetin e Tij në një pozitë kaq të lartë sa që askush tjetër nuk mund ta arrijë atë. Por kjo pozitë nuk arrihet kot. Profetit i jepet kjo detyrë:

“Edhe gjatë natës, me anë të këtij (Kurani) fal *tehexhudin*, kjo është shtesë për ty!” (17:80)

Pohimi që Profeti i Islamit<sup>savs</sup> me të vërtetë do të arrijë gradën e lavdëruar, u plotësua gjatë jetës së tij, gjë që e panë edhe vetë kundërshtarët. Kur Profeti<sup>savs</sup> doli nga Meka në gjendje arratie, kjo sure e Kuranit i dha profecinë në formë lutjeje që ai përsëri do të hynte në Mekë duke trumbetuar:

“Erdhi e vërteta dhe u zhdruk e rrema. Sigurisht, e rrema është e përcaktuar të zhduket” (17:82). Njësoj si drita, kur largohet errësira.

Pas kësaj, ajeti 86 flet për shpirtin. Kur njerëzit e pyetën Profetin Muhammed<sup>savs</sup> se çfarë është shpirti, Zoti i Madhërishëm atij i siguroi përgjigjen: “Shpirti nuk është asgjë tjetër përveçse një urdhër i Zotit tim”.

Të krishterët besojnë, po ashtu edhe muslimanët, që *Hazret Isai*<sup>as</sup> është *shpirt prej Allahut*. Ajeti i mësipërm tregon se kjo nuk është një pozitë që i jepet vetëm *Hazret Isait*<sup>as</sup>, sepse edhe ai lindi me urdhrin e Allahut, njësoj siç e gjithë jeta lindi me urdhrin e Allahut gjatë fillimit të botës.

Kjo temë sqarohet më tej edhe në fund të kësaj sureje, duke thënë se të thuash se *Hazret Isai*<sup>as</sup> ishte i biri i Zotit vetëm për faktin se ai lindi pa baba, është një padrejtësi e madhe. E gjithë lavdia është e Allahut, që nuk ka nevojë as për bir dhe as dikush tjetër të jetë ortak në sundimin e Tij. Pra, Ai asnjëherë nuk pati nevojë për ndonjë shoqëruar, për ta ndihmuar Atë në gjendje dobësie.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithë-mëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

Xhuzi 15

2. I Shenjtë është Ai që çoi robin e Tij gjatë një nate nga Xhamia e Shenjtë deri në Xhaminë e Largët, së cilës i kemi bekuar rrethinën, që t'i tregonim disa nga shenjat Tona. Sigurisht, Ai është Gjithëdëgjuesi, Gjithëshikuesi.<sup>1</sup>

سُبْحَانَ الَّذِي أَسْرَى بِعَبْدِهِ لَيْلًا مِّنَ الْمَسْجِدِ الْحَرَامِ إِلَى الْمَسْجِدِ الْأَقْصَا الَّذِي بَرَكْنَا حَوْلَهُ لِنُرِيَهُ مِنَ الْإِنبَاءِ إِنَّهُ هُوَ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ ②

3. Dhe Musait i dhamë Librin dhe atë e bëmë udhëzim për bijtë e Izraelit: “Mos merrni si mbrojtës dikë tjetër përveç Meje.”

وَإِنَّا مُوسَىٰ أَنْكَبْتُ وَجَعَلْنَاهُ هُدًى لِّبَنِي إِسْرَائِيلَ إِلَّا تَتَّخِذُوا مِن دُونِي وَكِيَلًا ③

4. (Këta ishin) pasardhës të atyre që Ne mbartëm bashkë me Nuhun. Pa dyshim, ai ishte rob shumë mirënjohës.

ذُرِّيَّةَ مَنْ حَمَلْنَا مَعَ نُوحٍ إِنَّهُ كَانَ عَبْدًا شَكُورًا ④

5. Dhe ua bëmë të qartë dekretin në Libër bijve të Izraelit: “Ju me siguri do të bëni dy herë trazira në tokë dhe do të ngriheni duke bërë tirani të madhe.

وَقَضَيْنَا إِلَىٰ بَنِي إِسْرَائِيلَ فِي الْكِتَابِ لَتُفْسِدُنَّ فِي الْأَرْضِ مَرَّتَيْنِ وَلَتَعْلُنَّ عُلُوًّا كَبِيرًا ⑤

6. Kështu, kur erdhi koha e premtimit të parë prej të dyjave, ngritëm kundër jush disa robër

فَإِذَا جَاءَ وَعْدُ أُولَاهُمَا بَعَثْنَا عَلَيْكُمْ عِبَادًا لَّنَا أُولِي بَأْسٍ شَدِيدٍ فَجَاسُوا

1. Kurani i Shenjtë përmend dy udhëtime shpirtërore të Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, njëri quhet *Isra* dhe tjetri *Miraxh*. Në *Isra*, Zoti i Madhërisëm e çon Profetin Muhammed<sup>savs</sup> në Palestinë dhe kjo nuk do të thotë se ai ka shkuar fizikisht, por shpirtërisht. Andaj, kur dikush e pyeti: Na thuaj se si është filan ndërtesë e Palestinës?, sipas hadithit, para syve të Profetit<sup>savs</sup> u shfaq ndërtesa në fjalë dhe ai ia përshkroi atë (Buhari, nr. 4710).

Tanët që ishin shumë të fuqishëm në luftë. Atëherë, ata u futën nëpër lagje në mënyrë shkatërrimtare. Ishte një premtim i kryer.<sup>2</sup>

خَلَّلَ الدِّيَارِ طُ وَكَانَ وَعْدًا مَّفْعُولًا ٥

7. Më pas juve ju kemi kthyer pushtetin mbi ta dhe ju ndihmuam me pasuri dhe fëmijë dhe ju shtuam shumë në numër.<sup>3</sup>

ثُمَّ رَدَدْنَا لَكُمُ الْكُرَّةَ عَلَيْهِمْ وَأَمْدَدْنَاكُمْ بِأَمْوَالٍ وَوَبْنِينَ وَجَعَلْنَاكُمْ أَكْثَرَ نَفِيرًا ٥

8. Po bëtë të mira, do t'i bëni të mira vetvetes dhe po bëtë të këqija, për vete do t'i keni. Kështu që, kur

إِنْ أَحْسَنْتُمْ أَحْسَنْتُمْ لِأَنْفُسِكُمْ ٥ وَإِنْ أَسَأْتُمْ فَلَهَا ٥ فَإِذَا جَاءَ وَعْدُ الْآخِرَةِ

2. Ndëshkimi i parë i zuri izraelitët pas *Hazret Davudit*<sup>as</sup>, dhe i dyti pas *Hazret Isait*<sup>as</sup>. Bibla tregon se hebrenjtë ishin bërë një komb i fuqishëm pas *Hazret Musait*<sup>as</sup> dhe, në kohën e *Davudit*<sup>as</sup>, ata hodhën themelet e një mbretërie të fuqishme, e cila vazhdoi të lulëzonte për ca kohë pas vdekjes së tij. Pastaj ajo filloi të binte në mënyrë graduale. Në vitin 608 p.e.s. Palestina u shkatërrua nga një forcë egjiptiane nën faraonin Neko dhe izraelitët u vunë nën ndikimin e Egjiptit (Jew. Enc., vëll. 6, f. 665). Humbja e fuqisë së tyre të përkohshme dhe shkatërrimi e shkretimi i tyre, megjithatë, nuk i shtyu izraelitët të ndreqnin gabimet e tyre. Profeti Jeremia i paralajmëroi të hiqnin dorë nga ligësitë, përndryshe zemërimi i Perëndisë do t'i pushtonte, por ata nuk i kushtuan vëmendje Jeremisë. Në mbretërimin e Jehojakimit, Nabukadnetsari i Babilonisë bëri pushtimin e tij të parë në Palestinë dhe mori disa nga arkat e tempullit, por qyteti u kursye nga ashpërsia e një rrethimi. Në vitin 597 p.e.s. gjithashtu qyteti ra viktimë e një zie të rëndë buke. Rebelimi i Zedekisë shkaktoi një pushtim të dytë nga Nabukadnetsari në vitin 587 p.e.s. dhe pas një rrethimi prej një viti e gjysmë, qyteti u dorëzua. Mbreti Zedekia iku nga qyteti, por u kap rob. Bijtë e tij ia vranë, i nxorën sytë dhe e lidhën me pranga dhe e çuan në Babiloni. Tempulli, pallati i mbretit dhe të gjitha ndërtesat e mëdha në qytet u dogjën, elita e priftërinjve dhe udhëheqësit e tjerë u vranë dhe shumë njerëz u çuan në robëri (Jew. Enc. vëll. 6, f. 665 dhe vëll. 7, f. 122 nën zërin "Jerusalem").

3. Judenjtë ia dolën mirë në mërgim. Iu ripërtërinë besimi e përkushtimi fetar; studiuam literaturën e Mbretërisë, e përshtatën sipas nevojave të komunitetit të tyre të ringjallur dhe nxitën shpresën e rikthimit në Palestinë. Rreth vitit 545 p.e.s., kjo aspiratë mori një formë më të qartë. Bënë një marrëveshje të fshehtë me Kirin, Mbretin e Medias dhe të Persisë, dhe e ndihmuam atë të pushtonte Babilonin. Babilonia iu dorëzua ushtrisë së tij pa rezistencë në korrik të vitit 539 p.e.s. Si shpërblim për shërbimet e tyre, Kiri i lejoi hebrenjtë të ktheheshin në Jerusalem dhe gjithashtu i ndihmoi të rindërtonin Tempullin (The Historians' History of the World, vëll. II, f. 126; Jew. Enc., vëll. 7, nën "Jerusalem"; Enc. Bib., nën "Cirus" dhe Bibla, 2 i Kronikave 36:22-23). Një pjesë e madhe e mërgimtarëve u kthyen në Jerusalem (Esdra 1:3-5). Punimet e rindërtimit të Tempullit përparuan në mënyrë të qëndrueshme dhe përfunduan në vitin 516 p.e.s.. Këtyre ngjarjeve dhe prosperitetit të mëvonshëm të hebrenjve u referohet ajeti në koment. E gjithë kjo, megjithatë, u parashikua nga *Hazret Musai*<sup>as</sup> shumë kohë përpara se të ndodhte (Bibla, Ligji i Përtërirë 30:1-5). Lexoni edhe 2:103.

do të vijë premtimi tjetër, që ata t'ju prishin fytyrat dhe të hynë në Xhami, sikur hynë herën e parë, dhe të shkatërrojnë tërësisht çfarëdo që mbizotërojnë.<sup>4</sup>

9. Mundet që Zoti juaj t'ju mëshirojë. Nëse do të përsërisni, do të përsërisim edhe Ne. Dhe Ne kemi bërë xhehenemin si rrethues për mohuesit.”<sup>5</sup>

10. Pa dyshim, ky Kuran udhëzon drejt asaj që është më e qëndrueshmja, dhe besimtarëve që bëjnë vepra të mira u jep lajmin e mirë që ata kanë një shpërblim të madh.

11. Kurse ata që nuk besojnë në *ahiret*, atyre u kemi përgatitur ndëshkim të dhimbshëm.

لِيَسْؤُوا وُجُوهَكُمْ وَلِيَدْخُلُوا الْمَسْجِدَ  
كَمَا دَخَلُوهُ أَوَّلَ مَرَّةٍ وَ لِيَتَّبِعُوا  
مَا عَلَّمْتُمْ بَيِّنَاتٍ ۝

عَسَىٰ رَبُّكُمْ أَنْ يَرْحَمَكُمْ ۚ وَإِنْ عُدتُّمْ  
عُدْنَا ۗ وَجَعَلْنَا جَهَنَّمَ لِلْكَافِرِينَ حَصِيرًا ۝

إِنَّ هَذَا الْقُرْآنَ يَهْدِي لِلَّتِي هِيَ أَقْوَمُ  
وَيُبَشِّرُ الْمُؤْمِنِينَ الَّذِينَ يَعْمَلُونَ الصَّالِحَاتِ  
أَنَّ لَهُمْ أَجْرًا كَبِيرًا ۝

وَ أَنَّ الَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ بِالْآخِرَةِ أَعْتَدْنَا  
لَهُمْ عَذَابًا أَلِيمًا ۝

4. Ky ajet flet për rikthimin e dytë të judenjve në ligësi dhe padrejtësi, si dhe për dënimin që i goditi ata si pasojë. Ata e persekutuan *Hazret Isain*<sup>as</sup>, tentuan ta kryqëzonin atë dhe ta shuanin xhematin e tij. Atëherë, Zoti i goditi me një ndëshkim të tmerrshëm, kur në vitin 70 e.s., forcat romake nën drejtimin e Titit e pushtuan vendin dhe mes rrethanave të një tmerrri të pashembullt, Jerusalemi u shkatërrua dhe Tempulli i Solomonit u dogj (Enc. Bib., nën “Jerusalem”). Kjo fatkeqësi ndodhi kur *Hazret Isai*<sup>as</sup> ishte ende duke jetuar diku në Kashmir. Këtë ndëshkim e parashikoi edhe *Hazret Musai*<sup>as</sup> në Ligji i Përtërirë 32:18-26. Mund të theksohet se edhe në Bibël, profecia për dënimin e dytë përmendet pas profecisë që flet për dënimin e parë (Bibla, Ligji i Përtërirë kap. 28). Për më tepër, përpara profecisë së dytë përmendet edhe profecia e kthimit të judenjve në Jerusalem (Bibla, Ligji i Përtërirë 30:1-5). E gjithë kjo tregon se profecia biblike e përmendur në Ligj. 32:18-26, flet për dënimin e dytë, të cilit i referohet edhe Kurani në ajetin 17:5. Ajeti nënkupton një paralajmërim edhe për muslimanët se, ashtu si judenjtë, edhe atyre mund t'u ndodhin ngjarje të tilla, nëse përfshihen në ligësi e padrejtësi dhe nuk heqin dorë prej saj.

5. Në kohët e vona, kur Bijtë e Izraelit do ta zotëronin Palestinën edhe një herë, kjo do të ndodhte për shkak të ligësive të muslimanëve, që ishin përgjegjës për Palestinën, kurse hebrenjtë sërish do të viheshin në sprovë. Tani, nëse ata do të kenë mëshirë ndaj njerëzve të pushtuar, pushtimi i tyre mund të zgjatet, në të kundërtën, me sa duket, nuk do t'i pushtojë sërish një popull i vetëm, por Zoti i Madhërishtëm do të krijojë rrethanat që superfuqitë nuk do t'i lejojnë hebrenjtë të mbeten në Palestinë.

12. Njeriu thërret të keqen sikur thërret të mirën. Njeriu është shumë i ngutshëm.

وَيَدْعُ الْإِنْسَانَ بِالشَّرِّ دُعَاءَهُ بِالْخَيْرِ ط  
وَكَانَ الْإِنْسَانُ عَجُولًا ۝

13. Ne bëmë natën dhe ditën dy shenja. E fshimë shenjën e natës dhe shenjën e ditës e bëmë ndriçuese, që ju të kërkonti bekim prej Zotit tuaj dhe që të mësoni numrin e viteve si dhe llogaritjen. Dhe çdo gjë shpjeguam shumë qartë.

وَجَعَلْنَا اللَّيْلَ وَالنَّهَارَ آيَاتٍ فَمَحْوَنًا  
آيَةَ اللَّيْلِ وَجَعَلْنَا آيَةَ النَّهَارِ مُبْصِرَةً  
لِتَبْتَغُوا فَضْلًا مِّن رَّبِّكُمْ وَلِتَعْلَمُوا عَدَدَ  
السِّنِينَ وَالْحِسَابِ ط وَكُلَّ شَيْءٍ فَصَّلْنَاهُ  
تَفْصِيلًا ۝

14. Çdo njeriu i lidhëm dosjen e veprave të tij në qafë. Atë do t'ia nxjerrim Ditën e Kiametit si një Libër, që ai do ta gjejë të hapur.<sup>6</sup>

وَكُلَّ إِنْسَانٍ أَلْزَمْنَاهُ طِيبَ لُغْمِهِ ط  
وَ نَخْرُجُ لَهُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ كِتَابًا يَلْقَاهُ  
مَنْشُورًا ۝

15. “Lexoje librin tënd! Vetja jote është e mjaftueshme sot që të të kërkojë llogari.”

اقْرَأْ كِتَابَكَ ط كَفَىٰ بِنَفْسِكَ الْيَوْمَ عَلَيْكَ  
حَسِيبًا ۝

16. Ai që udhëzohet, udhëzohet për veten e tij dhe ai që humbet, humbet kundër vetes së tij. Asnjë mbartës nuk do të mbajë barrën e tjetrit. Dhe Ne nuk ndëshkojmë, derisa nuk dërgojmë një të dërguar.

مِن اهْتَدَىٰ فَإِنَّمَا يَهْتَدِي لِنَفْسِهِ ۚ وَمَنْ  
ضَلَّ فَإِنَّمَا يَضِلُّ عَلَيْهَا ۗ وَلَا تَزِرُ وَازِرَةٌ  
وِزْرَ أُخْرَىٰ ط وَمَا كُنَّا مُعَذِّبِينَ حَتَّىٰ  
نَبْعَثَ رَسُولًا ۝

17. Kur vendosim të shkatërrojmë një vendbanim, urdhërojmë të

وَإِذَا أَرَدْنَا أَن نُهْلِكَ قَرْيَةً أَمَرْنَا

6. Në këtë ajet fjala arabe është *tair*, që do të thotë *shpend*, dhe në kuptimin alegorik ajo nënkupton edhe veprën, sepse çdo vepër, qoftë e mirë apo e keqe, pas realizimit ikën si një fluturak dhe munda e kënaqësia e saj përfundojnë duke lënë pas ndikimin e saj në zemër, i rëndë ose i lehtë qoftë ai. Sipas Kuranit, parimisht çdo vepër e njeriut gdhend fshehtas një ndikim të vet. Në raport me këtë, ekzekutohet vepra e Zotit të Madhërishtëm, e cila nuk e lë mëkatin ose mirësinë e njeriut të humbasë. Madje, gjurmët e veprës së njeriut shkruhen në zemrën e tij, në fytyrën e tij, në sytë dhe veshët e tij, në duart dhe këmbët e tij. Kjo përbën një libër të fshehtë veprash, që do të shpaloset hapur në botën tjetër.

pasurit e tij (të punojnë sipas qejfit të tyre), më pas ata bëjnë ligësi në të. Kështu vërtetohet vendimi mbi të dhe Ne e shkatërrojmë tërësisht.

18. Njerëzit e sa shumë kohërave kemi shkatërruar pas Nuhut! Zoti yt është i mjaftueshëm për të qenë i Gjithinformuar, Gjithëshikues ndaj mëkateve të robërve të Tij.

19. Ai që kërkon të shpejtën (pra, jetën e kësaj bote), Ne në këtë (botë) i japim me shpejtësi atë që duam, kujt të duam, më pas përgatisim xhehenemin për të. Ai hidhet në të i fajësuar, i përzënë.

20. Dhe ai që kërkon *ahiretin*, (që) përpiqet siç duhet përpjekur për të dhe është besimtar, përpjekja e tij do të ketë mirënjohje.

21. Ne ndihmojmë prej dhuratës së Zotit tënd që të gjithë, edhe këta, edhe ata. Dhe dhurata e Zotit tënd nuk ndalet.

22. Shih sesi u japim epërsi disave mbi disa të tjerë. Dhe *ahireti* është më i madhi edhe në pozita, më i madhi edhe në epërsi.

23. Mos bëj të adhurueshëm tjetër me Allahun, sepse do të mbetesh i fajësuar, i braktisur.

مُتْرَفِيهَا فَفَسَقُوا فِيهَا فَحَقَّ عَلَيْهَا الْقَوْلُ  
فَدَمَّرْنَاهَا تَدْمِيرًا ۝

وَكَمْ أَهْلَكْنَا مِنَ الْقُرُونِ مِنْ بَعْدِ نُوحٍ  
وَكَفَىٰ بِرَبِّكَ بِذُنُوبِ عِبَادِهِ خَبِيرًا  
بَصِيرًا ۝

مَنْ كَانَ يُرِيدُ الْعَاجِلَةَ عَجَلْنَا لَهُ فِيهَا  
مَا نَشَاءُ لِمَنْ نُرِيدُ ثُمَّ جَعَلْنَا لَهُ جَهَنَّمَ  
يَصْلُهَا مَذْمُومًا مَذْحُورًا ۝

وَمَنْ أَرَادَ الْآخِرَةَ وَسَعَىٰ لَهَا سَعْيَهَا وَهُوَ  
مُؤْمِنٌ فَأُولَٰئِكَ كَانَ سَعْيُهُمْ مَشْكُورًا ۝

كُلًّا نُمِدُّ هُوْلَاءَ وَهَؤُلَاءَ مِنْ عَطَاءِ  
رَبِّكَ ۖ وَمَا كَانَ عَطَاءُ رَبِّكَ مَحْظُورًا ۝

أَنْظُرْ كَيْفَ فَضَّلْنَا بَعْضَهُمْ عَلَىٰ بَعْضٍ  
وَلِلْآخِرَةِ أَكْبَرُ دَرَجَاتٍ وَأَكْبَرُ تَفْضِيلًا ۝

لَا تَجْعَلْ مَعَ اللَّهِ إِلَهًا آخَرَ فَتَقْعُدَ  
عَنْ مَذْمُومًا مَّحْدُورًا ۝



24. Zoti yt ka vendosur të mos adhurosh askënd tjetër, por vetëm Atë dhe të bësh mirësi ndaj prindërve. Nëse ndonjëri prej tyre arrin pleqërinë pranë teje, ose të dy, mos u thuaj as “uh!”, dhe as mos i qorto dhe drejtoju atyre me fjalë të buta e të nderuara.

25. Afroje krahun e përlësisë nga mëshira për të dy dhe thuaj: “O Zoti im! Mëshiroji ata ashtu siç ata më rritën mua në vogëli!”

26. Zoti juaj di më së miri çfarë keni në shpirtin tuaj. Nëse jeni të sinqertë, atëherë (dijeni se) ndaj atyre që pendohen shumë, Ai është shumë Falës.

27. Dhe jepi të afërmit të drejtën e tij, po ashtu edhe nevojtarit dhe udhëtarit, e mos shpenzo si dorëshpuar.

28. Sigurisht, dorëshpuarit janë vëllezër të djajve dhe djalli është tepër mosmirënjohës ndaj Zotit të tij.

29. Nëse ty të duhet t’u shmangesh atyre, duke kërkuar mëshirën e Zotit tënd që ti e shpreson, thuaju fjalë të buta.

30. Mos e mbaj dorën të varur në qafë (nga koprracia) dhe as mos e lësho tërësisht, sepse do të mbetesh i qortuar, i penduar.

وَقَضَىٰ رَبُّكَ أَلَّا تَعْبُدُوا إِلَّا إِيَّاهُ  
وَيَالُوَالِدَيْنِ إِحْسَانًا ۗ إِنَّمَا يُبَلِّغَنَّ عَنْكَ  
الْكَبِيرَ أَحَدُهُمَا أَوْ كِلَيْهِمَا فَلَا تَقُلْ لَهُمَا  
أَفٍّ وَلَا تَنْهَرُهُمَا وَقُلْ لَهُمَا قَوْلًا كَرِيمًا ﴿١٥﴾

وَاخْفِضْ لَهُمَا جَنَاحَ الذُّلِّ مِنَ الرَّحْمَةِ  
وَقُلْ رَبِّ ارْحَمْهُمَا كَمَا رَبَّيْتَنِي صَغِيرًا ﴿١٦﴾

رَبُّكُمْ أَعْلَمُ بِمَا فِي نُفُوسِكُمْ ۗ إِنَّ تَقُونُوا  
صَالِحِينَ فَإِنَّهُ كَانَ لِلْأَوَّابِينَ غَفُورًا ﴿١٧﴾

وَأْتِ ذَا الْقُرْبَىٰ حَقَّهُ وَالْمِسْكِينَ وَابْنَ  
السَّبِيلِ وَلَا تَبْذُرْ تَبْذِيرًا ﴿١٨﴾

إِنَّ الْمُبَدِّرِينَ كَانُوا إِخْوَانَ الشَّيْطَانِ ۗ  
وَكَانَ الشَّيْطَانُ لِرَبِّهِ كَفُورًا ﴿١٩﴾

وَأَمَّا تُعْرَضُونَ عَنْهُمْ فَبَعَا رَحْمَةً مِّنْ  
رَّبِّكَ تَرْجُوهَا فَقُلْ لَهُمْ قَوْلًا مَّيْسُورًا ﴿٢٠﴾

وَلَا تَجْعَلْ يَدَكَ مَغْلُولَةً إِلَىٰ عُنُقِكَ  
وَلَا تَبْسُطْهَا كُلَّ الْبَسْطِ فَتَقْعُدَ مَلُومًا  
مَّحْسُورًا ﴿٢١﴾

31. Sigurisht, Zoti yt atij që do, ia shton të mirat dhe (edhe) ia pakëson. Ndaj robërve të Tij, Ai është i Gjithinformuar, Gjithëshikues.

32. Mos vrisni fëmijët tuaj nga frika e skamjes. Ne i ushqejmë edhe ata, edhe ju. Njëmend, vrasja e tyre është një gabim i madh.

33. Dhe mos iu afroni kurvërisë. Njëmend ajo është e turpshme dhe një rrugë e keqe.

34. Dhe mos vritni pa të drejtë njeri, gjë që Allahu e bëri të ndaluar. Ai që vritet padrejtësisht, Ne i kemi dhënë të drejtën trashëgimtarit të tij (për të kërkuar hak), andaj, ai nuk duhet ta shkelë kufirin në çështjen e vrasjes; sigurisht, ai është i ndihmuar.

35. Mos iu afroni pasurisë së jetimit, përveçse në mënyrën më të mirë, derisa ai të arrijë moshën e pjekurisë. Përmbusheni premtimin. Pa dyshim, do të pyeteni për premtimin.

36. Plotësoni masën kur matni dhe peshoni me peshore të drejtë. Kjo është e mbarë dhe më e mirë në përfundim.

37. Mos mbaj një qëndrim për të cilin nuk ke dije. Sigurisht, do të pyeteni për veshët, sytë dhe zemrat, (për) secilën prej tyre.

إِنَّ رَبَّكَ يَبْسُطُ الرِّزْقَ لِمَنْ يَشَاءُ  
ع وَيَقْدِرُ ۗ إِنَّهُ كَانَ بِعِبَادِهِ خَبِيرًا بَصِيرًا ۝

وَلَا تَقْتُلُوا أَوْلَادَكُمْ خَشْيَةَ إِمْلَاقٍ ۗ  
نَحْنُ نَرِزُقُهُمْ وَإِيَّاكُمْ ۗ إِنَّ قَتْلَهُمْ كَانَ  
خِطَاءً كَبِيرًا ۝

وَلَا تَقْرَبُوا الزَّانِيَةَ إِنَّهُ كَانَ فَاحِشَةً ۗ  
وَسَاءَ سَبِيلًا ۝

وَلَا تَقْتُلُوا النَّفْسَ الَّتِي حَرَّمَ اللَّهُ إِلَّا  
بِالْحَقِّ ۗ وَمَنْ قَتَلَ مَظْلُومًا فَقَدْ جَعَلْنَا  
لَوْلِيِّهِ سُلْطَانًا فَلَا يُسْرِفُ فِي الْقَتْلِ ۗ  
إِنَّهُ كَانَ مَنصُورًا ۝

وَلَا تَقْرَبُوا مَالَ الْيَتِيمِ إِلَّا بِالَّتِي  
هِيَ أَحْسَنُ حَتَّىٰ يَبْلُغَ أَشُدَّهُ ۗ وَأَوْفُوا  
بِالعَهْدِ ۗ إِنَّ العَهْدَ كَانَ مَسْئُولًا ۝

وَأَوْفُوا الْكَيْلَ إِذَا كِلْتُمْ وَزِنُوا  
بِالْقِسْطَاسِ الْمُسْتَقِيمِ ۗ ذَلِكَ خَيْرٌ وَ  
أَحْسَنُ تَأْوِيلًا ۝

وَلَا تَقْفُ مَا لَيْسَ لَكَ بِهِ عِلْمٌ ۗ إِنَّ  
السَّمْعَ وَالْبَصَرَ وَالْفُؤَادَ كُلُّ أُولَٰئِكَ  
كَانَ عَنْهُ مَسْئُولًا ۝

38. Mos ec në tokë duke u mburrur. Njëmend, ti nuk mund ta çash tokën dhe as nuk mund të arrish lartësinë e maleve.

وَلَا تَمْشِ فِي الْأَرْضِ مَرَحًا ۚ إِنَّكَ لَنْ  
تَخْرِقَ الْأَرْضَ وَلَنْ تَبْلُغَ الْجِبَالَ  
ظُورًا ۝٣٨

39. Për të gjitha këto gjëra, e keqja e tyre është e urryer te Zoti yt.

كُلُّ ذَلِكَ كَانَ سَيِّئُهُ عِنْدَ رَبِّكَ مَكْرُوهًا ۝٣٩

40. Këto janë nga urtia që Zoti yt t'i shpalli ty. Mos bëj të adhurueshëm tjetër pos Allahut, përndryshe do të hidhesh në xhehenem, i qortuar, i flakur.

ذَلِكَ مِمَّا أَوْحَىٰ إِلَيْكَ رَبُّكَ مِنَ الْحِكْمَةِ ۗ  
وَلَا تَجْعَلْ مَعَ اللَّهِ إِلَهًا آخَرَ فَتُلْفَىٰ  
فِي جَهَنَّمَ مَلُومًا مَّدْحُورًا ۝٤٠

41. A mos vallë Zoti juaj ju ka zgjedhur për djem dhe Vetë mori vajza prej engjëjve?! Ju përnjëmend thoni një fjalë të rëndë!

أَفَأَصْفِكُمْ رَبُّكُمْ بِالْبَنِينَ وَاتَّخَذَ مِنَ  
عِبَادِ الْمَلَائِكَةِ إِنَاثًا ۚ إِنَّكُمْ لَتَقُولُونَ قَوْلًا عَظِيمًا ۝٤١

42. Ne kemi përsëritur (temat) në këtë Kuran, që ata të meditojnë. Megjithatë, kjo vetëm se i bëri ata të largohen me urrejtje.

وَلَقَدْ صَرَّفْنَا فِي هَذَا الْقُرْآنِ لِيَذَّكَّرُوا ۚ  
وَمَا يَزِيدُهُمْ إِلَّا نُفُورًا ۝٤٢

43. Thuaj: Po të kishte Ai të adhurueshëm të tjerë, siç thonë ata, edhe ata do ta kërkonin rrugën drejt Zotit të Arshit.

قُلْ لَوْ كَانَ مَعَهُ آلِهَةٌ كَمَا يَقُولُونَ  
إِذًا لَاتَّبَعُوا إِلَىٰ ذِي الْعَرْشِ سَبِيلًا ۝٤٣

44. I Pastër është Ai dhe shumë i lartë nga ajo që thonë.

سُبْحٰنَهُ وَتَعَالَىٰ عَمَّا يَقُولُونَ عُلُوًّا كَبِيرًا ۝٤٤

45. Atë e përkujtojnë shtatë qiejt dhe toka dhe kushdo që gjendet në to. Dhe nuk ka gjë që nuk e përkujton me lavdinë e Tij, por ju nuk e kuptoni të përkujtuarit e tyre. Pa dyshim, Ai është shumë i Përmbajtur, shumë Falës.

تُسَبِّحُ لَهُ السَّمَوَاتُ السَّبْعُ وَالْأَرْضُ وَمَنْ  
فِيهِنَّ ۗ وَإِنْ مِنْ شَيْءٍ إِلَّا يُسَبِّحُ بِحَمْدِهِ  
وَلَكِنْ لَا تَفْقَهُونَ تَسْبِيحَهُمْ ۗ إِنَّهُ  
كَانَ حَلِيمًا عَفُورًا ۝٤٥

46. Kur ti reciton Kuranin, Ne bëjmë një ndarje të fshehtë mes teje dhe atyre që nuk besojnë në *ahiret*.

47. Dhe vendosim perde mbi zemrat e tyre, që të mos e kuptojnë, dhe barrë në veshët e tyre. Kur ti përmend Zotin tënd të Vetëm në Kuran, ata ta kthejnë shpinën me urrejtje.

48. Ne e dimë më së miri çfarë ata duan ta dëgjojnë, kur ata mbajnë veshin te ti dhe kur janë duke pëshpëritur (dhe) kur keqbërësit thonë: “Ju ndiqni vetëm një njeri të magjepsur!”

49. Shiko se çfarë shembujsh japin për ty! Kështu, ata devijuan dhe nuk gjejnë dot rrugën.

50. Dhe thanë: “Kur të bëhemi eshtra e pluhur, a me të vërtetë do të ringjallemi si krijesa të reja?!”

51. Thuaj: “Daç bëhuni gur a hekur,

52. ose ndonjë krijesë tjetër më e madhe që ju vjen ndërmend!” Ata thonë: “Kush do të na kthejë (në krijesa të reja)?” Thuaj: “Ai që ju krijoi për herë të parë.” Atëherë ata tundin kokën përpara teje dhe thonë: “Kur do të ndodhë kjo?” Thuaj: “Mund të ndodhë shpejt.

53. Ditën kur Ai do t’ju thërrasë, do t’i përgjigjeni me lavdinë e Tij dhe do të mendoni se shumë pak keni qëndruar.”

وَإِذَا قَرَأْتَ الْقُرْآنَ جَعَلْنَا بَيْنَكَ وَبَيْنَ  
الَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ بِالْآخِرَةِ حِجَابًا  
مَّسْتُورًا ﴿٤٦﴾

وَجَعَلْنَا عَلَى قُلُوبِهِمْ أَكِنَّةً أَنْ يَفْقَهُوهُ  
وَفِي آذَانِهِمْ وَقْرًا ۗ وَإِذَا ذَكَرْتَ رَبَّكَ  
فِي الْقُرْآنِ وَحْدَهُ وَكُنَّا عَلَى آدْبَارِهِمْ  
نُفُورًا ﴿٤٧﴾

نَحْنُ أَعْلَمُ بِمَا يَسْتَمِعُونَ بِهِ إِذْ يَسْتَمِعُونَ  
إِلَيْكَ وَإِذْ هُمْ نَجْوَى إِذْ يَقُولُ الظَّالِمُونَ  
إِنْ تَنبِعُونَ إِلَّا لِرَجُلٍ مَّسْحُورًا ﴿٤٨﴾

أَنْظُرْ كَيْفَ صَرَبُوا لَكَ الْأَمْثَالَ فَضَلُّوا  
فَلَا يَسْتَطِيعُونَ سَبِيلًا ﴿٤٩﴾

وَقَالُوا ۗ إِذَا كُنَّا عِظَامًا وَرُفَاتًا ۗ إِنَّا  
لَمَبْعُوثُونَ خَلْقًا جَدِيدًا ﴿٥٠﴾

قُلْ كُونُوا حِجَارَةً أَوْ حَدِيدًا ﴿٥١﴾  
أَوْ خَلْقًا مِمَّا يَكْبُرُ فِي صُدُورِكُمْ ۚ  
فَسَيَقُولُونَ مَنْ يُعِيدُنَا ۖ قُلِ الَّذِي فَطَرَكُمْ  
أَوَّلَ مَرَّةٍ ۚ فَسَيَغْضُوبُونَ إِلَيْكَ ۚ رُءُوسُهُمْ  
وَيَقُولُونَ مَتَى هُوَ ۖ قُلْ عَسَى أَنْ يَكُونَ  
قَرِيبًا ﴿٥٢﴾

يَوْمَ يَدْعُوكُمْ فَتَسْتَجِيبُونَ بِحَدِيثِهِمْ وَتَتَّبِعُونَ  
إِنْ لَيْسَتْ إِلَّا قَلِيلًا ﴿٥٣﴾

54. Dhe thuaju robërve të Mi të thonë atë që është më e mira. Pa dyshim, djalli fut ngatërresë mes tyre. Njëmend, djalli për njeriun është armik i hapur.

وَقُلْ لِعِبَادِي يَقُولُوا الَّتِي هِيَ أَحْسَنُ  
إِنَّ الشَّيْطَانَ يَنْزِعُ بَيْنَهُمْ ۗ إِنَّ الشَّيْطَانَ  
كَانَ لِلْإِنْسَانِ عَدُوًّا مُّبِينًا ۝

55. Zoti juaj ju njeh më së miri. Në dashtë ju mëshiron, në dashtë ju ndëshkon. Dhe Ne nuk të kemi dërguar si mbikëqyrës.

رَبُّكُمْ أَعْلَمُ بِكُمْ ۗ إِنَّ يَسَاءَ يَرْحَمُكُمْ أَوْ  
إِنَّ يَسَاءَ يُعَذِّبُكُمْ ۗ وَمَا أَرْسَلْنَاكَ عَلَيْهِمْ  
وَكَيْلًا ۝

56. Zoti yt di më së miri atë që gjendet në qiej e tokë. Sigurisht, Ne u dhamë epërsi disa Profetëve mbi disa të tjerë dhe Davudit i dhamë Zeburin.<sup>7</sup>

وَرَبُّكَ أَعْلَمُ بِمَنْ فِي السَّمَوَاتِ  
وَالْأَرْضِ ۗ وَكَفَدْنَا بَعْضَ النَّبِيِّينَ  
عَلَى بَعْضٍ وَأَتَيْنَا دَاوُدَ زَبُورًا ۝

57. Thuaj: “Lusni ata që i vlerësoni në vend të Tij. Ata as nuk kanë fuqi t’ju largojnë vështirësinë e as ta ndryshojnë.”

قُلِ ادْعُوا الَّذِينَ زَعَمْتُمْ مِنْ دُونِهِ فَلَا  
يَمْلِكُونَ كَشْفِ الضُّرِّ عَنْكُمْ وَلَا تَحْوِيلًا ۝

58. Pikërisht këta të cilët i lusin ata, do të kërkojnë mjetin (për t’u afuar) drejt Zotit të tyre se kush prej tyre do të jetë më i afërt (për t’u bërë ndërmjetës), do të presin mëshirën e Tij dhe do të kenë frikë nga ndëshkimi i Tij. Njëmend, ndëshkimi i Zotit tënd është i tillë që duhet ruajtur prej tij.

أُولَئِكَ الَّذِينَ يَدْعُونَ يَبْتَغُونَ إِلَى رَبِّهِمُ  
الْوَسِيلَةَ أَيُّهُمْ أَقْرَبُ وَيَرْجُونَ رَحْمَتَهُ  
وَيَحَافُونَ عَذَابَهُ ۗ إِنَّ عَذَابَ رَبِّكَ كَانَ  
مَحْدُورًا ۝

59. Nuk ka vendbanim që përpara Ditës së Kiametit Ne të mos e shkatërrojmë atë ose të mos e ndëshkojmë me një ndëshkim të rëndë. Kjo është e shkruar në Libër.<sup>8</sup>

وَإِنْ مِنْ قَرِيَةٍ إِلَّا نَحْنُ مُهْلِكُوهَا قَبْلَ  
يَوْمِ الْقِيَامَةِ أَوْ مُعَذِّبُوهَا عَذَابًا شَدِيدًا ۗ  
كَانَ ذَلِكَ فِي الْكِتَابِ مَسْطُورًا ۝

7. Disa njerëz Zeburin (Psalmet) e quajnë shariat, por një nga kuptimet e fjalës *zebur* është pjesë. Kështu që, zebur do të thotë pjesë të vogla me këshilla të vyera. Nëse i studiojmë Psalmet, ato kështu ngjajnë.

8. Ky ajet parashikon se në kohën e vonshme, gjithë botën do ta mbërthejnë ndëshkimet, dhe

60. Asgjë nuk na pengoi të dërgonim shenjat, përveçse të parët ato i quajtën gënjeshtra. Dhe themudëve u dhamë devenë si shenjë të ndritur, por ata e dhunuan. Ne i dërgojmë shenjat vetëm për të frikësuar.

وَمَا مَنَعَنَا أَنْ نُرْسِلَ بِالْآيَاتِ إِلَّا أَنْ كَذَّبَ بِهَا الْأَوَّلُونَ<sup>٥٧</sup> وَآتَيْنَا ثَمُودَ النَّاقَةَ مُبْصِرَةً فَظَلَمُوا بِهَا<sup>٥٨</sup> وَمَا نُرْسِلُ بِالْآيَاتِ إِلَّا تَحْوِيلًا<sup>٥٩</sup>

61. Dhe (kujto) kur të thamë: Zoti yt përnjëmend i ka vënë në rreth njerëzit. Ëndrrën që Ne ta treguam, e bëmë vetëm si sprovë për njerëzit,<sup>9</sup> gjithashtu edhe pemën, të mallkuar në Kuran.<sup>10</sup> Ne i frikësojmë shkallë-shkallë, por kjo i shton ata vetëm në një rebelim të madh.

وَإِذْ قُلْنَا لَكَ إِنَّ رَبَّكَ أَحَاطَ بِالنَّاسِ<sup>٦٠</sup> وَمَا جَعَلْنَا الرَّيِّيَا الَّتِي آرَيْتَكَ إِلَّا فِتْنَةً<sup>٦١</sup> لِلنَّاسِ وَالشَّجَرَةَ الْمَلْعُونَةَ فِي الْقُرْآنِ<sup>٦٢</sup> وَنُحُوفُهُمْ<sup>٦٣</sup> فَمَا يَزِيدُهُمْ إِلَّا طُغْيَانًا<sup>٦٤</sup> كَبِيرًا<sup>٦٥</sup>

62. Dhe kur u thamë engjëjve: “Bëni sexhde për Ademin!”, ata ranë në sexhde, përveç djallit (pra, Iblisit). Ai tha: “A të bëj sexhde për atë që krijove prej balte?!”

وَإِذْ قُلْنَا لِلْمَلَائِكَةِ اسْجُدُوا لِآدَمَ فَسَجَدُوا إِلَّا إِبْلِيسَ<sup>٦٦</sup> قَالَ ءَأَسْجُدُ لِمَنْ خَلَقْتَ طِينًا<sup>٦٧</sup>

63. (Dhe) tha: “A e pe, ky qenka ai që e nderove mbi mua?! Nëse më jep kohë deri në Ditën e Kiametit, unë patjetër do të shkatërroj pasardhësit e tij, përveç disave.”

قَالَ أَرَأَيْتَكَ هَذَا الَّذِي كَرَّمْتَ عَلَيَّ<sup>٦٨</sup> لَئِنِ أَخَّرْتَنِي إِلَى يَوْمِ الْقِيَامَةِ لَأُحْتَسِبَنَّ<sup>٦٩</sup> ذُرِّيَّتَهُ إِلَّا قَلِيلًا<sup>٧٠</sup>

sipas fjalës së Hazret Isait<sup>as</sup> popujt do të ngrihen kundër popujve dhe sipas Kuranit të Shenjtë “Ditën kur do të tronditet fort ajo që tronditet; pasuesja do ta pasojë atë.” (79:7-8), saqë njerëzimi do të shtanget.

9. Ajeti i referohet ëndrrës së përmendur në ajetin 2 të kësaj sureje. Në këtë ëndërr, Zoti i tregoi Profetit Muhammed<sup>savs</sup> se ai po udhëhiqte faljen për të gjithë Profetët izraelitë dhe të tjerët në xhaminë Aksa të Jerusalemit, vend i cili ishte *kiblja* e judenjve. Kjo ishte një profeci se në të ardhmen e shpejt pasuesit e atyre Profetëve do t’i bashkoheshin Islamit, njëherësh, Zoti do t’u përgatiste shkatërrim të madh kundërshtarëve të tij.

10. Fjala *shexhere* d.m.th. *pemë*, e cila ndër të tjera ka edhe kuptimin *fis*. Andaj *pema e mallkuar* mund t’i referohet asaj pjese të popullit hebre, që u quajt e mallkuar në Kuranin e Shenjtë (5:14; 5:61; 5:65; 5:79). Ky interpretim bazohet edhe në faktin se vetë kjo sure quhet Bijtë e Izraelit, dhe në këtë ajet përmendet ëndrra që është përshkruar në fillim të sures, në të cilën Profeti<sup>savs</sup> u gjend në Jerusalem dhe drejtoi faljen për Profetët izraelitë.

64. (Zoti) tha: “Shko! Kushdo që do të të ndjekë prej tyre, do t’ju jepet xhehenemi si dënim i plotë.

قَالَ أَذْهَبَ فَمَنْ تَبِعَكَ مِنْهُمْ فَإِنَّ جَهَنَّمَ  
جَزَاءُكُمْ جَزَاءً مَوْفُورًا ﴿١٥﴾

65. Ngashënjeje kë të mundesh prej tyre përmes zërit tënd, sillua kalorësit dhe këmbësorët e tu, bëhu ortak i tyre në pasuri e fëmijë dhe premtaji!” Djalli atyre ua premtan vetëm mashtrimin!

وَاسْتَفْزِرُ مِنْ اسْتَطَعَتْ مِنْهُمْ بِصَوْتِكَ  
وَاجْلِبْ عَلَيْهِمْ بِخَيْلِكَ وَرَجِلِكَ وَشَارِكِهِمْ  
فِي الْأَمْوَالِ وَالْأَوْلَادِ وَعَدَّهُمْ ط وَمَا  
يَعِدُّهُمْ الشَّيْطَانُ إِلَّا عُرْوًا ﴿١٦﴾

66. Sigurisht, mbi robërit e Mi nuk do të kesh pushtet. Zoti yt është i mjaftueshëm si Mbrojtës.

إِنَّ عِبَادِي لَيْسَ لَكَ عَلَيْهِمْ سُلْطَانٌ ط  
وَكَفَى بِرَبِّكَ وَكِيلًا ﴿١٧﴾

67. Zoti juaj është Ai që për ju lëviz anijet në det, që ju të kërkon bekimet e Tij. Sigurisht, Ai është shumë Mëshirëbërës ndaj jush.

رَبُّكُمْ الَّذِي يُرْجِي لَكُمْ الْفُلْكَ فِي الْبَحْرِ  
لِيَتَّبِعُوا مِنْ فَضْلِهِ ط إِنَّهُ كَانَ بِكُمْ رَحِيمًا ﴿١٨﴾

68. Dhe kur ju prek vështirësia në det, ju humb çdokush të cilin e lusnit në vend të Tij. E kur Ai ju shpëton duke ju sjellë drejt tokës, ju i shmangeni. Njeriu është shumë mosmirënjohës!

وَإِذَا مَسَّكُمُ الضُّرُّ فِي الْبَحْرِ صَلَّ مَنْ  
تَدْعُونَ إِلَّا إِلَاهًا ط فَلَمَّا مَجَّكُمْ إِلَى الْبَرِّ  
أَعْرَضْتُمْ ط وَكَانَ الْإِنْسَانُ كَفُورًا ﴿١٩﴾

69. A jeni të sigurt që Ai nuk do t’ju fundosë afër tokës ose nuk do t’ju dërgojë ndonjë uragan të tillë që ju të mos gjeni më mbrojtës për vete?!

أَفَأَمِنْتُمْ أَنْ يُخَيِّفَ بِكُمْ جَانِبَ الْبَرِّ أَوْ  
يُرْسِلَ عَلَيْكُمْ حَاصِبًا ثُمَّ لَا تَجِدُوا لَكُمْ  
وَكِيلًا ﴿٢٠﴾

70. Apo jeni të sigurt që Ai nuk do t’ju kthejë në të dhe nuk do t’ju dërgojë një stuhi të fuqishme ere, që t’ju mbysë ju bashkë me mohimin tuaj, e më pas ju të mos gjeni asnjë hakmarrës kundër Nesh për këtë?!

أَمْ أَمِنْتُمْ أَنْ يُعِيدَكُمْ فِيهِ تَارَةً أُخْرَى  
فَيُرْسِلَ عَلَيْكُمْ قَاصِفًا مِنَ الرِّيحِ  
فَيَغْرِقَكُمْ بِمَا كَفَرْتُمْ ط ثُمَّ لَا تَجِدُوا لَكُمْ  
عَلِيًّا بِهِ تَبِيحًا ﴿٢١﴾

71. Njëmend, Ne u dhamë nder bijve të Ademit, i mbartëm në tokë e në det, i furnizuam me të pastrat dhe mbi shumëkënd që kemi krijuar, atyre u dhamë epërsi të madhe.

وَلَقَدْ كَرَّمْنَا بَنِي آدَمَ وَحَمَلْنَهُمْ فِي  
الْبَرِّ وَالْبَحْرِ وَرَزَقْنَهُم مِّنَ الطَّيِّبَاتِ  
وَفَضَّلْنَاهُمْ عَلَى كَثِيرٍ مِّمَّنْ خَلَقْنَا  
تَفْضِيلًا ﴿٧١﴾

72. Ditën kur do të thërrasim çdo grup me udhëheqësin e tyre. Atëherë, pikërisht ata të cilëve u jepet Libri i (veprave të) tyre në dorën e djathtë, do ta lexojnë Librin, dhe atyre nuk do t'u bëhet padrejtësi asnjë fije.

يَوْمَ نَدْعُوا كُلَّ أُنَاسٍ بِإِمَامِهِمْ فَمَنْ  
أُوْتِيَ كِتَابَهُ بِيَمِينِهِ فَأُولَٰئِكَ يَقْرَءُونَ  
كِتَابَهُمْ وَلَا يُطْلَمُونَ فَتِيلًا ﴿٧٢﴾

73. Dhe ai që është i verbër në këtë (botë), do të jetë i verbër edhe në *ahiret*,<sup>11</sup> edhe më i devijuar nga udha.

وَمَنْ كَانَ فِي هَذِهِ أَعْمَىٰ فَهُوَ فِي الْآخِرَةِ  
أَعْمَىٰ وَأَضَلُّ سَبِيلًا ﴿٧٣﴾

74. Mundej që ata të sprovonin ty rreth asaj që Ne të shpallëm, në mënyrë që të trilloje diçka tjetër mbi Ne, dhe atëherë, ata menjëherë do të të bënin shok.

وَإِنْ كَادُوا لَيَفْتِنُونَكَ عَنِ الَّذِي أَوْحَيْنَا  
إِلَيْكَ لِتَقَرَّىٰ عَلَيْنَا غَيْرَهُ ۗ وَإِذَا  
لَا تَحْذُوكَ حَلِيلًا ﴿٧٤﴾

75. Dhe po të mos kishim forcuar ty, mundej që ti të anoje nga ata ndopak.

وَلَوْ لَا أَنْ تَبْتُلَكَ لَقَدْ كِدْتَ تَرْكُنَ  
إِلَيْهِمْ شِيًّا قَلِيلًا ﴿٧٥﴾

76. Atëherë, Ne do të të bënim ty të shijoje dyfish ndëshkimin edhe të jetës, edhe të vdekjes dhe ti më pas nuk do të gjeje asnjë ndihmës kundër Nesh.

إِذَا لَأَذَقْنَاكَ ضِعْفَ الْحَيَاةِ وَضِعْفَ  
الْمَمَاتِ ثُمَّ لَا تَجِدُكَ عَلَيْنَا نَصِيرًا ﴿٧٦﴾

77. Gjithashtu mundej që ata të të shkullnin nga toka që të të dëbonin prej saj, atëherë, pas teje, edhe ata nuk do të mbeteshin gjatë.

وَإِنْ كَادُوا لَيَسْتَفْرِزُونَكَ مِنَ الْأَرْضِ  
لِيُخْرِجُوكَ مِنْهَا وَإِذَا لَا يَلْبُثُونَ خَلْقَكَ  
إِلَّا قَلِيلًا ﴿٧٧﴾

11. Nuk do të thotë që ai që është i verbër fizikisht në këtë botë, i tillë do të jetë edhe në *ahiret*, por do të thotë që ai që nuk pati shikimin shpirtëror, pavarësisht se kishte mundësi, do t'i mohohet shikimi shpirtëror edhe në *ahiret*.



78. Kjo ka qenë praktikë (Jona) me të Dërguarit Tanë që dërguam para Teje dhe, në praktikën Tonë, ti nuk do të gjesh ndryshim.

سُنَّةٌ مِّن قَدْ أَرْسَلْنَا قَبْلَكَ مِنْ رُّسُلِنَا  
وَلَا تَجِدُ لِسُنَّتِنَا تَحْوِيلًا ﴿٧٨﴾

79. Fal namazin nga rënia e diellit deri në errësimin e natës dhe përmbahu (leximit të) Kuranit në sabah. Vërtet, leximi i Kuranit në sabah dëshmohej.

اقِمِ الصَّلَاةَ لِذِكْرِكَ الشَّمْسِ إِلَى غَسَقِ  
الْأَيْلِ وَقُرْآنِ الْفَجْرِ ۗ إِنَّ قُرْآنَ الْفَجْرِ  
كَانَ مَشْهُودًا ﴿٧٩﴾

80. Edhe gjatë natës, me anë të këtij (Kurani) fal *tehexhudin*,<sup>12</sup> kjo është shtesë për ty. Mundet që Zoti yt të të vendosë në pozitë të lavdëruar.

وَمِنَ الْإِيلِ فَتَهَجَّدْ بِهِ نَافِلَةً لَّكَ ۗ عَسَىٰ  
أَن يَبْعَثَكَ رَبُّكَ مَقَامًا مَّحْمُودًا ﴿٨٠﴾

81. Thuaj: O Zoti im! Më mundëso hyrje me vërtetësi dhe më mundëso dalje me vërtetësi<sup>13</sup> dhe më dhuro prej Vetes ndihmës të fuqishëm!

وَقُلْ رَبِّ ادْخِلْنِي مَدْخَلَ صِدْقٍ  
وَأَخْرِجْنِي مَخْرَجَ صِدْقٍ ۚ وَاجْعَلْ لِي  
مِن لَّدُنكَ سُلْطَانًا نَّصِيرًا ﴿٨١﴾

82. Thuaj: Erdhi e vërteta dhe u zhduk e rrema; pa dyshim, e rrema është për t'u zhdukur!

وَقُلْ جَاءَ الْحَقُّ وَزَهَقَ الْبَاطِلُ ۗ إِنَّ  
الْبَاطِلَ كَانَ زَهُوقًا ﴿٨٢﴾

83. Ne zbresim nga Kurani atë që është shërim dhe mëshirë për besimtarët, kurse keqbërësve u shton vetëm humbje.

وَنُنزِّلُ مِنَ الْقُرْآنِ مَا هُوَ شِفَاءٌ وَرَحْمَةٌ  
لِّلْمُؤْمِنِينَ ۗ وَلَا يَزِيدُ الظَّالِمِينَ إِلَّا  
خَسَارًا ﴿٨٣﴾

84. Kur i japim një të mirë njeriut, ai largohet dhe e mban anën e tij, dhe

وَإِذَا أَنْعَمْنَا عَلَى الْإِنْسَانِ أَعْرَضَ

12. Namazi i natës.

13. I Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> ndonëse së pari doli nga Meka e pastaj hyri në Medinë, Allahu i Madhërisëm së pari përmendi hyrjen e pastaj daljen. Në këtë ajet, hyrja nënkupton edhe hyrjen përsëri në Mekë për ta çliruar atë. Në këtë mënyrë, Allahu i Madhërisëm mu në kohën kur Profeti<sup>savs</sup> po largohej nga Meka, i dha lajmin e mirë se ai do të hynte sërish në të, duke e ngushëlluar kështu për dhimbjen që mund të kishte për shkak të mërgimit. Lexoni edhe 28:86.

kur e prek e keqja, mbetet shumë i dëshpëruar.

85. Thuaj: Çdokush vepron në bazë të natyrës së tij. Zoti yt e di më së miri atë që është më i udhëzuar i rrugë.

86. Dhe të pyesin për shpirtin. Thuaj: Shpirti është prej urdhrit të Zotit tim dhe (për të) juve ju është dhënë një dije e paktë.

87. Po të donim, Ne do ta tërhiqim atë që të shpallëm ty dhe më pas për këtë ti nuk do të gjeje mbrojtës kundër Nesh.

88. Por vetëm me mëshirën e Zotit tënd (ti ke shpëtuar). Sigurisht, bekimi i Tij mbi ty është i madh.

89. Thuaj: Edhe sikur të mblidhen njerëzit dhe xhindët për të sjellë shembullin e këtij Kurani, nuk mund ta sjellin dot shembullin e tij, edhe nëse ata janë ndihmës të njëri-tjetrit.

90. Sigurisht, Ne kemi shpjeguar në këtë Kuran çdo shembull për njerëzit. Por shumica e njerëzve mohuan vetëm me mosmirënjohje.

91. Dhe thanë: “Kurrresi nuk do të të besojmë ty, derisa nuk do të na nxjerrësh nga toka një burim uji gurgullues.

92. Ose të kesh kopsht hurmash dhe rrushi, dhe përmes të bësh të rrjedhin lumenj.

وَنَابِجَانِيهِ ۚ وَإِذَا مَسَّهُ الشَّرْكَانَ يُوَسَّوۙ

قُلْ كُلٌّ يَعْمَلُ عَلَىٰ شَاكِلَتِهِ ۗ فَرَبُّكُمْ  
عَلَّمَ بِمَنْ هُوَ أَهْدَىٰ سَبِيلًا ۝٨٥

وَيَسْأَلُونَكَ عَنِ الرُّوحِ ۗ قُلِ الرُّوحُ مِنْ  
أَمْرِ رَبِّي وَمَا أُوتِيتُمْ مِنَ الْعِلْمِ إِلَّا  
قَلِيلًا ۝٨٦

وَلَيْنَ شِئْنَا لَنُدْهَبَنَّ بِالَّذِي أُوْحَيْنَا  
إِلَيْكَ ۖ ثُمَّ لَا تَجِدُ لَكَ بِهِ عَايِنًا ۚ وَكَيْلًا ۝٨٧

إِلَّا رَحْمَةً ۖ مِنْ رَبِّكَ ۗ إِنَّ فَضْلَهُ كَانَ عَلَيْكَ  
كَبِيرًا ۝٨٨

قُلْ لَئِنِ اجْتَمَعَتِ الْإِنْسُ وَالْجِنُّ عَلَىٰ  
أَنْ يَأْتُوا بِمِثْلِ هَذَا الْقُرْآنِ لَا يَأْتُونَ  
بِمِثْلِهِ وَلَوْ كَانَ بَعْضُهُمْ لِبَعْضٍ ظَهِيرًا ۝٨٩

وَلَقَدْ صَرَّفْنَا لِلنَّاسِ فِي هَذَا الْقُرْآنِ مِنْ  
كُلِّ مَثَلٍ ۚ فَأَبَىٰ أَكْثَرُ النَّاسِ إِلَّا كُفُورًا ۝٩٠

وَقَالُوا لَنْ نُؤْمِنَ بِكَ حَتَّىٰ تُفَجِّرَ لَنَا مِنَ  
الْأَرْضِ يَنْبُوعًا ۝٩١

أَوْ تَكُونَ لَكَ جَنَّةٌ مِنْ نَخِيلٍ وَعِنَبٍ  
فَتَفَجِّرَ الْأَنْهَارَ خِلَالَهَا تَفْجِيرًا ۝٩٢

93. Ose të bësh të bjerë qielli copë-copë mbi ne, siç pretendon ti, ose të na sjellësh Allahun dhe engjëjt ballë për ballë.

أَوْ تَسْقِطَ السَّمَاءَ كَمَا زَعَمْتَ عَلَيْنَا كِسْفًا  
أَوْ تَأْتِيَنَا بِاللَّهِ وَالْمَلَائِكَةِ قَبِيلًا ﴿١٧﴾

94. Ose të kesh një shtëpi prej ari, ose të ngjitesh në qiell. Dhe ne kurrësi nuk do ta besojmë ngjitjen tënde, gjersa të zbresësh mbi ne një libër që ta lexojmë.” Thuaj: I pastër është Zoti im (nga këto gjëra)! A nuk jam thjesht një njeri, i dërguar?!<sup>14</sup>

أَوْ يَكُونَ لَكَ بَيْتٌ مِّن زُرْحٍ أَوْ تَرْفٌ  
فِي السَّمَاءِ ۗ وَلَنْ نُؤْمِنَ لِرُقِيِّكَ حَتَّى  
تُنزِّلَ عَلَيْنَا كِتَابًا نَّقْرُؤُهُ ۗ قُلْ سُبْحَانَ  
رَبِّي هَلْ كُنْتُ إِلَّا بَشَرًا رَسُولًا ﴿١٨﴾

95. Dhe njerëzit nuk i ndaloi të besonin asgjë tjetër përveçse, kur u erdhi udhëzimi, thanë: “Vallë, Allahu dërgoi një njeri, të dërguar?!”

وَمَا مَنَعَ النَّاسَ أَنْ يُؤْمِرُوا إِذْ جَاءَهُمْ  
الْهُدَىٰ إِلَّا أَنْ قَالُوا أَبَعَثَ اللَّهُ بَشَرًا  
رَّسُولًا ﴿١٩﴾

96. Thuaj: Po të kishte në tokë engjëj që ecnin qetësisht, Ne do t'u zbrisnim prej qiellit një engjëll të dërguar.

قُلْ لَوْ كَانَ فِي الْأَرْضِ مَلَائِكَةٌ يَّمْشُونَ  
مُطْمَئِنِّينَ لَنَزَّلْنَا عَلَيْهِم مِّن السَّمَاءِ مَلَكًا  
رَّسُولًا ﴿٢٠﴾

97. Thuaj: Allahu është i mjaftueshëm si Dëshmitar mes meje dhe jush. Sigurisht, ndaj robërve të Tij, Ai është i Gjithinformuar, Gjithëshikues.

قُلْ كَفَىٰ بِاللَّهِ شَهِيدًا بَيْنِي وَبَيْنَكُمْ ۗ  
إِنَّهُ كَانَ بِعِبَادِهِ خَبِيرًا بَصِيرًا ﴿٢١﴾

98. Dhe i udhëzuar është vetëm ai që e udhëzon Allahu; kurse për ata që Ai i cilëson të devijuar, nuk mund të gjesh asnjë ndihmës përveç Atij. Ne do t'i tubojmë ata për fytyrash

وَمَنْ يَهْدِ اللَّهُ فَهُوَ الْمُهْتَدِ ۗ وَمَنْ يُضِلِّ  
فَلَنْ تَجِدَ لَهُم أَوْلِيَاءَ مِنْ دُونِهِ ۗ  
وَنَحْشُرُهُمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ عَلَىٰ وُجُوهِهِمْ عُمِّيًّا

14. Profeti<sup>savs</sup> në këtë ajet dha argumentin që i dërguari i Zotit është thjesht njeri, dhe si i tillë, ai nuk mund të ngjitet në qiell fizikisht. Është e çuditshme që pavarësisht se Profeti Muhammed<sup>savs</sup> arsyetoi me të qenët e tij si njeri për të mos u ngjitur në qiell, prapëseprapë një pjesë e madhe e muslimanëve besojnë se Hazret Isai<sup>as</sup> u ngjit në qiell, ndërkohë, sipas Kuranit të Shenjtë, edhe ai ishte një njeri i dërguar (5:76).

Ditën e Kiametit, të verbër, memecë e të shurdhër. Streha e tyre do të jetë xhehenemi; sa herë që ai zbehët, do t'ua shtojmë djegien.

99. Ky është ndëshkimi i tyre sepse mohuan shenjat Tona dhe thanë: “Kur të bëhemi eshtra dhe pluhur, a do të ngrihemi sërish si një krijesë e re?!”

100. A nuk e dinë që Allahu që krijoi qiejt dhe tokën është i Fuqishëm të krijojë të ngjashmin e tyre?! Dhe për ta Ai caktoi një afat; nuk ka mëdyshje në të. Mirëpo të padrejtët mohuan vetëm me mosmirënjohje.

101. Thuaj: Edhe sikur të zotëronit thesaret e mëshirës së Zotit tim, prapëseprapë do t'i mbanit të bllokuara nga frika e shterimit. Njeriu është shumë koprrac!

102. Ne i dhamë Musait nëntë shenja të qarta. Andaj pyeti bijtë e Izraelit. Kur u erdhi ai, Faraoni i tha: “O Musa! Besoj se ti përnjëmend je i magjepsur!”

103. Ai tha: “Ti e ke kuptuar se këto shenja plot drite, nuk i ka dërguar tjetërkush përveç Zotit të qiejve dhe të tokës dhe unë, o Faraon, besoj se ti përnjëmend je i shkatërruar!”

104. Atëherë ai vendosi t'i çrrënjoste nga toka dhe Ne i fundosëm atë dhe të gjithë ata që ishin bashkë me të.

وَبِكُمْ وَأَصْنَامًا مَّاؤُوهُمْ جَهَنَّمَ ۖ كَلَّمَا  
خَبَّتْ زُرَّتُهُمْ سَعِيرًا ﴿١٥﴾

ذَلِكَ جَزَاءُ هُمُ بِآثَمِهِمْ كَفَرُوا بِآيَاتِنَا  
وَقَالُوا إِذَا كُنَّا عِظَامًا وَرُفَاتًا إِيَّانَا  
لَمَبْعُوثُونَ خَلْقًا جَدِيدًا ﴿١٥﴾

أَوَلَمْ يَرَوْا أَنَّ اللَّهَ الَّذِي خَلَقَ السَّمَوَاتِ  
وَالْأَرْضِ قَادِرٌ عَلَىٰ أَنْ يَخْلُقَ مِثْلَهُمْ  
وَجَعَلَ لَهُمْ أَجَلًا لَا رَيْبَ فِيهِ ۗ فَآبَى  
الظَّالِمُونَ إِلَّا كُفُورًا ﴿١٥﴾

قُلْ لَوْ أَنْتُمْ تَمْلِكُونَ خَزَائِنَ رَحْمَةِ  
رَبِّي إِذَا لَأَمْسَكْتُمْ خَشْيَةَ الْإِنْفَاقِ ۗ  
وَكَانَ الْإِنْسَانُ قَتُورًا ﴿١٥﴾

وَلَقَدْ آتَيْنَا مُوسَىٰ تِسْعَ آيَاتٍ بَيِّنَاتٍ فَسَأَلَ  
بَنِي إِسْرَائِيلَ إِذْ جَاءَهُمْ فَقَالَ لَهُ فِرْعَوْنُ  
إِنِّي لَأَظُنُّكَ يُمُوسَىٰ مَسْحُورًا ﴿١٥﴾

قَالَ لَقَدْ عَلِمْتَ مَا أَنْزَلَ هَؤُلَاءِ إِلَّا  
رَبُّ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ بِصَآئِرٍ ۗ وَإِنِّي  
لَأَظُنُّكَ يُفْرَعُونَ مُتَّبُورًا ﴿١٥﴾

فَأَرَادَ أَنْ يَنْتَفِرَهُمْ مِنَ الْأَرْضِ فَأَعْرَفْنَاهُ  
وَمَنْ مَعَهُ جَمِيعًا ﴿١٥﴾

105. Dhe pas kësaj u thamë bijve të Izraelit: “Banoni në tokën (e premtuar),<sup>15</sup> dhe kur do të vijë premtimi i *ahiretit*,<sup>16</sup> do t’ju risjellim të gjithë bashkë.”

106. Ne e zbritëm me të vërtetën dhe ai zbriti me të vërtetën. Dhe ty të dërguam vetëm si sihariqdhënës dhe paralajmërues.

107. Dhe Kuranin e ndamë, që t’ua lexosh njerëzve me ndalesa. Ne e zbritëm atë pjesë-pjesë.

108. Thuaj: Besojeni këtë ose mos e besoni. Sigurisht, atyre që u ishte dhënë dija përpara këtij, kur u recitohej, binin me mjekrat për tokë, duke bërë sexhde.

109. Dhe thoshin: “I Shenjtë është Zoti ynë! Premtimi i Zotit tonë do të përmbushet patjetër!”

110. Dhe ata binin me mjekrat për tokë, duke qarë, dhe kjo ua shtonte përulësinë.

Sexhdeja IV

111. Thuaj: Lusni Allahun ose lusni të Gjithëmëshirshmin. Cilindo ta lusni, Ai i ka emrat më të bukur. Në namazin tënd as mos e ngre shumë zërin, e as mos e ul shumë, dhe kërko një rrugë të mesme.<sup>17</sup>

وَ قُلْنَا مِنْ بَعْدِهِ لِنَبِيِّ إِسْرَائِيلَ اسْكُنُوا  
الْأَرْضَ فَإِذَا جَاءَ وَعْدُ الْآخِرَةِ جِئْنَا  
بِكُمْ لَفِيئًا ﴿١٥﴾

وَيَالْحَقِّ أَنْزَلْنَاهُ وَبِالْحَقِّ نَزَّلَهُ وَمَا  
أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا مُبَشِّرًا وَنَذِيرًا ﴿١٦﴾

وَقُرْآنًا فَرَقْنَاهُ لِتَقْرَأَهُ عَلَى النَّاسِ عَلَى  
مَكْثٍ وَنَزَّلْنَاهُ تَنْزِيلًا ﴿١٧﴾

قُلْ آمِنُوا بِهِ أَوْ لَا تُؤْمِنُوا إِنَّ الَّذِينَ  
أَوْتُوا الْحِلْمَ مِنْ قَبْلِهِ إِذَا يُتْلَى عَلَيْهِمْ  
يَخِرُّونَ لِلْأَذْقَانِ سُجَّدًا ﴿١٨﴾

وَ يَقُولُونَ سُبْحَانَ رَبِّنَا إِنْ كَانَ وَعْدُ رَبِّنَا  
لَمَفْعُولًا ﴿١٩﴾

وَيَخِرُّونَ لِلْأَذْقَانِ يَبْكُونَ وَيَزِيدُهُمْ  
خُشُوعًا ﴿٢٠﴾

قُلْ ادْعُوا اللَّهَ أَوْ ادْعُوا الرَّحْمَنَ أَيًّا مَا  
تَدْعُوا فَلَهُ الْأَسْمَاءُ الْحُسْنَىٰ ۗ وَلَا تَجْهَرُ  
بِصَلَاتِكَ وَلَا تُخَافُتْ بِهَا وَابْتَغِ بَيْنَ  
ذَلِكَ سَبِيلًا ﴿٢١﴾

15. D.m.th. në Palestinë.

16. D.m.th. – do t’i sjellim hebrenjtë në Palestinë për herë të tretë. Sipas kësaj profecie, sot ata janë pushtues të Palestinës. Lexoni edhe 17:5-9.

17. Ndalimi për t’u lutur me zë të lartë mund të jetë për shkak se kjo mund t’i shkaktojë dukjen njeriut, kurse ndalimi për t’u lutur pa zë, mund t’i shkaktojë harresën, si rrjedhojë edhe shpërqendrimin.

112. Dhe thuaj: “Lavdia është e Allahut që asnjëherë nuk mori bir, e as nuk ka qenë ndokush pjesëtar me Të në sundim, e as nuk ka qenë ndokush ndihmës i Tij nga dobësia”, dhe madhëroje Atë sa më shumë.

وَقُلِ الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي لَمْ يَتَّخِذْ وَلَدًا  
وَلَمْ يَكُنْ لَهُ شَرِيكٌ فِي الْمُلْكِ وَلَمْ  
يَكُنْ لَهُ وَاوِيٌّ مِنَ الذُّلِّ وَكَبِيرَةٌ تَكْبِيرًا ۝

## Surja 18 – El-Kehf

Surja El-Kehf është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka njëqind e njëmbëdhjetë ajete. Periudha e zbritjes së kësaj sureje është viti i katërt ose i pestë pas profetësisë.

Surja Kehf fillon me të njëjtën temë të sures së mëparshme, në të cilën pohohet fuqishëm se *Hazret Isai<sup>as</sup>* ishte vetëm një rob i Zotit. Gjithashtu, në mënyrë shumë të thjeshtë jep argumentin se ata që besojnë të kundërtën, nuk kanë fare dijeni se si lindi *Hazret Isai<sup>as</sup>* dhe as këtë që Allahu i Madhërishëm është i pastër nga procesi i riprodhimit, dhe nga ana tjetër, ata bëjnë një pretendim bosh, duke trilluar një gënjeshtër të madhe mbi Allahun.

Pas kësaj, përmenden të krishterët e parë sesi ata e mbrojtën njëshmërinë e Zotit dhe për këtë u detyruan të futeshin nëpër shpella, duke e lënë tokën e lirë. Por përpara se të flitej për banorët e shpellës, në ajetet e para thuhet që njerëzve u janë dhënë bekimet e kësaj bote që ata të sprovohen dhe do të vijë një kohë kur atyre do t'u rrëmbehen këto bekime për shkak të ligësive të tyre dhe do t'u dhurohen sërish atyre njerëzve, të cilët, për hir të Zotit, preferuan të jetonin nëpër shpella, në vend të tokës.

Më pas jepet shembulli i dy kopshteve, për shkak të të cilave, një njeri mburret përballë një njeriu tjetër, duke thënë se unë i kam të gjitha këto, kurse ti je duarbosh. Por bashkë me këtë vjen paralajmërimi që nëse shkaktoni mospëlqimin e Allahut të Madhërishëm, do t'ju bien copëza zjarri që do t'ju shkrumbojnë bashkë me mjetet tuaja. Pra, edhe një herë përsëritet tema që u tha në fjalët: “tokë shterpë”, në ajetin 9 të kësaj sureje.

Po kjo sure flet për një udhëtim të *Hazret Musait<sup>as</sup>*, në të cilin atë e shoqëronte *Hazret Isai<sup>as</sup>* në formën e një të riu. Gjatë këtij udhëtimi, atyre u bëhet me dije fundi i umetit të tyre, duke e përcaktuar atë si vendi ku atyre do t'u humbte peshku, pra, ushqimi i tyre shpirtëror, për të përfunduar sërish në det. Kjo shënjon periudhën paraislame, kur të krishterët kishin humbur spiritualitetin e vërtetë.

Më pas paraqitet *Hazret Profeti Muhammed<sup>savs</sup>* në formën e një njeriu të shenjtë, të cilin muslimanët në përgjithësi, e quajnë *Hazret Hidr*. Urtësitë që do t'i dhuroheshin Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, ishin përtej kapacitetit të *Hazret Musait<sup>as</sup>*, pasi ai dhe *umeti* i tij nuk kishin durimin e mjaftueshëm për to. Kështu, epërsia që ka Profeti Muhammed<sup>savs</sup> mbi *Hazret Musait<sup>as</sup>* është se atij Zoti i Madhërishëm ia komunikoi sekretet e urtësive.

Pas kësaj vjen çështja e Dhul-Kernejnit, që përsëri shënjon Profetin Muhammed<sup>savs</sup> që atij do t'i jepej sundimi i dy kohërave, të të parëve dhe të të mëvonshmeve. Hollësitë e udhëtimit që janë përmendur në këto ajete, kanë plot shenja dhe mësim dhe nuk mund të shpjegohen në këtë parathënie. Por një gjë është e qartë: *umeti* i Profetit Muhammed<sup>savs</sup> do të shtrihet edhe në Perëndim gjër aty, ku “dielli” duket se perëndon në “ujëra të turbullta” të mendimeve të gabuara të njerëzve, dhe edhe në

Lindje gjer aty ku nuk ka ndonjë pengesë mes tokës dhe diellit.

Fundi i kësaj sureje tregon bindshëm që surja flet për shkëlqimin dhe rënien e krishterimit. Shkëlqimi ishte për shkak të adhuruesve të parë të Zotit të Vetëm, kurse rënia erdhi kur besimi në një Zot erdhi duke u prishur, për t'u shndërruar më pas në qindra e mijëra zota. Kështu që, sot edhe shenjtoreve të kësaj feje praktikisht u jepet pozita e Zotit. Kurani i Shenjtë, në një nga ajetet e fundit të kësaj sureje, pohon:

*Ata që mohuan, a menduan se do të marrin për mbrojtës robërit e Mi, duke më lënë Mua?! (18:103)*

Zoti i Madhërishëm i kishte treguar qartazi Profetit Muhammed<sup>savs</sup> që kjo sure ka lidhje me Dexhallin. Prandaj, Profeti<sup>savs</sup> na këshilloi:

*Ai që lexon dhjetë ajetet e para dhe dhjetë ajete të fundit të kësaj sureje, do të jetë i mbrojtur nga Dexhalli. (Muslim, kitab: “Salatul-Musafirine ve kasruha”, nr. 1883; Ebu Davud, kitab: “El-Melahim”, nr. 4323.)*

Pavarësisht se edhe Profeti<sup>savs</sup> ishte njeri, por Zoti i Madhërishëm e porositi të deklaronte: Unë jam njeri si të gjithë ju, por jam i pastër nga çdolloj *shirku* (idhujtarie), andaj, nëse edhe ju dëshironi të keni takimin me Zotin e Madhërishëm, pastrojeni veten nga çdolloj *shirku*. Këto ajete japin edhe lajmin se shpallja e Zotit do të vazhdojë të vijë. Allahu i Madhërishëm do të vijojë të komunikojë me robërit e Tij të dëlirë që e mbajnë veten të pastër nga çdolloj *shirku*.





1. Me emrin e Allahut, të Gjithë-mëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Lavdia është e Allahut që zbriti mbi robin e Tij Librin, në të cilin nuk la asnjë shtrembësi,

الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي أَنْزَلَ عَلَى عَبْدِهِ الْكِتَابَ  
وَلَمْ يَجْعَلْ لَهُ عِوَجًا ①

3. (Libër) të qëndrueshëm, që ai prej Atij të alarmojë për një ndëshkim të rëndë dhe t'u japë besimtarëve që bëjnë të mira, lajmin e mirë se ata me siguri do të kenë një shpërblim të mirë.

فَيَمَّا يُمِيزُ بَأْسًا شَدِيدًا مِمَّنْ لَدُنْهُ  
وَيُبَشِّرَ الْمُؤْمِنِينَ الَّذِينَ يَعْمَلُونَ  
الصَّالِحَاتِ أَنَّ لَهُمْ أَجْرًا حَسَنًا ①

4. Në të do të banojnë gjithmonë.

مَا كَثَبْنَا فِيهِ أَبَدًا ①

5. Dhe t'i alarmojë ata që thanë: “Allahu mori një bir.”

وَيُنذِرَ الَّذِينَ قَالُوا اتَّخَذَ اللَّهُ وَلَدًا ①

6. Për këtë nuk kanë kurrfarë dijeje as ata e as baballarët e tyre. E rëndë është fjala që del nga gojët e tyre. Ata vetëm gënjejnë.

مَا لَهُمْ بِهِ مِنْ عِلْمٍ وَلَا لِآبَائِهِمْ كَبُرَتْ  
كَلِمَةً تَخْرُجُ مِنْ أَفْوَاهِهِمْ ① إِنَّ يَقُولُونَ  
إِلَّا كَذِبًا ①

7. A do të shkatërrosh veten nga brenga pas tyre që ata nuk po e besojnë këtë Fjalë?!

فَلَعَلَّكَ بَاخِعٌ نَفْسِكَ عَلَى آثَارِهِمْ ①  
لَمْ يُؤْمِنُوا بِهَذَا الْحَدِيثِ أَسَفًا ①

8. Njëmend, gjithçka që gjendet mbi tokë, e bëmë për zbukurimin e saj, që t'i sprovovjmë ata se kush prej tyre ka veprën më të mirë,

إِنَّا جَعَلْنَا مَا عَلَى الْأَرْضِ زِينَةً لَهَا  
لِنَبْلُوَهُمْ أَيُّهُمْ أَحْسَنُ عَمَلًا ①

9. dhe sigurisht, gjithçka që gjendet mbi të, do ta bëjmë tokë shterpë.

وَإِنَّا لَجَاعِلُونَ مَا عَلَيْهَا صَعِيدًا جُرُزًا ①

10. A mendon që banorët e shpellës dhe të shkrimeve ishin një ndër shenjat

أَمْ حَسِبْتَ أَنَّ أَصْحَابَ الْكَهْفِ وَالرَّقِيمِ ①

Tona të çuditshme?<sup>1</sup>

11. Kur disa të rinj u strehuan në shpellë, thanë: “O Zoti ynë! Jepna mëshirë prej Teje dhe dhurona urtësi në çështjen tonë!”

12. Ne ua mbyllëm veshët në shpellë (që të mos kenë kontakt me botën jashtë) për disa vjet.<sup>2</sup>

13. Më pas i ngritëm, që të dinim se cili prej të dy grupeve i llogarit saktë se sa kanë qëndruar ata (në të).

14. Ne të rrëfejmë ty lajmin e tyre me vërtetësi. Ata ishin disa të rinj që besuan Zotin e tyre dhe Ne ua shtuam udhëzimin.

15. Dhe ua lidhëm zemrat kur ata u ngritën. Pra, thanë: “Zoti ynë është Zoti i qiejve dhe i tokës; ne kurrsesi nuk do të adhurojmë të adhureshëm tjetër përveç Atij, se përndryshe, do të kishim thënë fjalë të padrejtë.

16. Ky popull yni mori të adhureshëm të tjerë përveç Atij! Pse vallë nuk sjellin ndonjë

كَانُوا مِنْ آيَاتِنَا عَجَبًا ﴿١٠﴾

إِذْ أَوَى الْفِتْيَةُ إِلَى الْكَهْفِ فَقَالُوا رَبَّنَا  
آتِنَا مِنْ لَدُنْكَ رَحْمَةً وَهَيِّئْ لَنَا مِنْ  
أَمْرِنَا رَشَدًا ﴿١١﴾

فَضْرَبْنَا عَلَى آذَانِهِمْ فِي الْكَهْفِ سِنِينَ  
عَدَدًا ﴿١٢﴾

ثُمَّ بَعَثْنَهُمْ لِنَعْلَمَ أَيُّ الْحِزْبَيْنِ أَحْصَى  
لِمَا لَبِثُوا أَمَدًا ﴿١٣﴾

نَحْنُ نَقُصُّ عَلَيْكَ نَبَأَهُمْ بِالْحَقِّ إِنَّهُمْ  
فِتْيَةٌ آمَنُوا بِرَبِّهِمْ وَزِدْنَاهُمْ هُدًى ﴿١٤﴾

وَرَبَطْنَا عَلَى قُلُوبِهِمْ إِذْ قَامُوا فَقَالُوا  
رَبُّنَا رَبُّ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ لَنْ نَدْعُوَ  
مِنْ دُونِهِ إِلَهًا لَقَدْ قُلْنَا إِذًا شَطَطًا ﴿١٥﴾

هَؤُلَاءِ قَوْمٌ اتَّخَذُوا مِنْ دُونِهِ آلِهَةً  
لَوْ لَا يَأْتُونَ عَلَيْهِمْ بِسُلْطَنٍ بَيِّنٍ لَفَمَّنْ

1. *As-haburr-rrekim* do të thotë *njerëzit e shkrimeve*. Banorët e shpellës lanë shkrime shumë të rëndësishme në shpellat e tyre, shkrime të cilat janë studiuar në këtë kohë, sidomos nga studiues evropianë. Edhe ky ajet përbën një mrekulli. Profeti Muhammed<sup>savs</sup> mund të kishte ditur për njerëzit e shpellës, por ai kurrsesi nuk mund të dinte se pikërisht këta do të ishin edhe njerëzit e shkrimeve, pa ia treguar Vetë Zoti, Njohësi i së padukshmes.

2. “*Sinin*” (vjet) është shumësi i vogël (*xhem’ kil-let*) i fjalës *senetun* (vit), dhe që mund të jetë nga 3 deri në 9 vjet. Pavarësisht se të krishterët që adhuronin Një Zot të Vetëm, për të shpëtuar besimin e tyre, jetuan nëpër shpella për më shumë se treqind vjet, por praktikisht në mënyrë të njehershme, ata nuk jetuan më gjatë se nëntë vjet. Pra, gjatë treqind viteve, sa herë që zbutej kundërshtimi, ata dilnin nga shpella.

argument të qartë rreth (besimit të) tyre?! Atëherë, kush mund të jetë më keqbërës sesa ai që trillon gënjeshtër mbi Allahun?!”

17. Dhe tani që jeni ndarë nga ata dhe nga ajo që ata adhurojnë përveç Allahut, strehohuni në shpellë! Zoti juaj do të përhapë për ju mëshirën e Tij dhe do t'ju lehtësojë punën tuaj.

18. Ti shikon diellin, kur lind, largohet nga shpella e tyre në anën e djathtë dhe kur perëndon, përvidhet prej tyre në anën e majtë, kurse ata janë në një vend të gjerë mes kësaj. Kjo është një prej shenjave të Allahut. Atë që e udhëzon Allahu, pikërisht ai është i udhëzuar, kurse për atë që e cilëson të devijuar Ai, ti nuk mund të gjesh ndonjë shok udhëzues.

19. Ti mendon se janë zgjuar, kurse ata janë në gjumë. Ne i kthejmë ata djathtas e majtas. Dhe qeni i tyre qëndron te pragu, duke zgjatur të dyja këmbët e para. Po t'i shikoje, do të ikje prej tyre me vrap dhe do të mbusheshe me frikë prej tyre.<sup>3</sup>

أَظْلَمَ مِمَّنِ افْتَرَىٰ عَلَى اللَّهِ كَذِبًا ۖ

وَإِذِ اعْتَزَلْتُمُوهُمْ وَمَا يُعْبُدُونَ إِلَّا  
اللَّهُ فَأَوَّا إِلَى الْكَهْفِ يَنْشُرْ لَكُمْ رَبُّكُمْ  
مِنْ رَحْمَتِهِ وَيَهَيِّئْ لَكُمْ مِنْ أَمْرِكُمْ  
مُرْفَقًا ۝

وَتَرَى الشَّمْسَ إِذَا طَلَعَتْ تَرُورٌ عَنْ  
كَهْفِهِمْ ذَاتَ الْيَمِينِ وَإِذَا غَرَبَتْ تَقْرِضُهُمْ  
ذَاتَ الشِّمَالِ وَهُمْ فِي فَجْوَةٍ مِنْهُ ۗ ذَلِكَ  
مِنْ آيَاتِ اللَّهِ ۗ مَنْ يَهْدِ اللَّهُ فَهُوَ الْمُهْتَدِ  
ۗ وَمَنْ يُضِلِلْ فَلَنْ تَجِدَ لَهُ وَلِيًّا مُرْشِدًا ۝

وَتَحْسَبُهُمْ آيْقَاطًا وَهُمْ رُقُودٌ ۗ وَنُقَلِّبُهُمْ  
ذَاتَ الْيَمِينِ وَذَاتَ الشِّمَالِ ۗ وَكَلْبُهُمْ بَاسِطٌ  
ذِرَاعَيْهِ بِالْوَصِيدِ ۗ لَوِاطِعَتَّ عَلَيْهِمْ  
لَوَلِيَّتَ مِنْهُمْ فَزَارًا وَكَلِمَاتَ مِنْهُمْ  
رُعبًا ۝

3. “Ti mendon se janë zgjuar, kurse ata janë në gjumë”: Komentuesit besojnë se këtu bëhet fjalë për gjumin fizik, gjë që nuk është e saktë. Fjala gjumë nënkupton gjendjen e tyre që ata nuk ishin në kontakt me botën jashtë. Po të ishte fjala për gjumin fizik, nuk do të thuhej “Po t’i shikoje, do të ikje prej tyre me vrap dhe do të mbusheshe me frikë prej tyre”. Një njeri që është në gjumë, nuk të bën as ndikim as nuk të frikëson. Në fakt, ata ishin njerëz shumë të fuqishëm, dhe sa herë që romakët tentuan t’i mësynin në shpellë, përballeshin me qenin e tyre. Banorët e shpellës menjëherë merrnin sinjalin që armiku është te dera dhe ata merrnin masat për t’u përballur ose për t’u fshehur.

20. Dhe kështu Ne i ngritëm (nga shkujdesja), që ata të pyesnin njëri-tjetrin. Njëri prej tyre tha: “Sa kohë keni qëndruar?” Ata thanë: “Kemi qëndruar një ose disa ditë.” Thanë: “Zoti juaj e di më së miri se sa keni qëndruar. Dërgoni njërin prej jush me këtë monedhë tuajën drejt qytetit dhe ai le të shikojë se cili është ushqimi më i pastër, dhe diçka prej atij ushqimi t’ju sjellë juve, gjithashtu, t’ua zbulojë sekretet (kundërshtarëve) me marifet<sup>4</sup> dhe askush të mos marrë vesh për ju.

21. Njëmend, ata janë të tillë që nëse ju pushtojnë, do t’ju gurëzojnë ose do t’ju kthejnë në grupin e tyre dhe ju kurrsesi nuk do të keni më sukses.”

22. Dhe kështu ua treguam situatën e tyre, që ata të dinin se premtimi i Allahut është i vërtetë dhe që Ora (e ndryshimit) është ajo që nuk ka mëdyshje në të. Kur ata debatonin me njëri-tjetrin çështjen e tyre, (disa) thanë: “Bëni një ndërtesë (si kujtim) mbi ta”. Zoti i tyre di më së miri rreth tyre. Ata që fituan në vendimin e tyre, thanë: “Ne patjetër do të ndërtojmë një faltore mbi ta”.

23. Do të thonë: “Ishin tre dhe i katërti ishte qeni i tyre”. Do të thonë duke hamendësuar të padukshmen: “Ishin pesë dhe i gjashti ishte qeni i tyre”. Dhe do të thonë: “Ishin shtatë

وَكَذَلِكَ بَعَثْنَاهُمْ لِيَتَسَاءَلُوا بَيْنَهُمْ ۗ قَالَ  
قَائِلٌ مِّنْهُمْ كَمْ لَبِئْتُمْ ۗ قَالُوا لَبِئْنَا يَوْمًا  
أَوْ بَعْضَ يَوْمٍ ۗ قَالُوا رَبُّكُمْ أَعْلَمُ بِمَا  
لَبِئْتُمْ ۗ فَابْعَثُوا أَحَدَكُمْ بِوَرِقِكُمْ  
هَذِهِ إِلَى الْمَدِينَةِ فَلْيَنْظُرْ أَيُّهَا أَرْكَى  
طَعَامًا فَلْيَأْتِكُمْ بِرِزْقٍ مِّنْهُ وَلْيَتَلَطَّفْ  
وَلَا يُسْعِرَنَّ بِكُمْ أَحَدًا ۝

إِنَّهُمْ إِنْ يَظْهَرُوا عَلَيْكُمْ يَرْجُمُوكُمْ  
أَوْ يُعِيدُوكُمْ فِي مِلَّتِهِمْ وَلَنْ تُفْلِحُوا إِذًا  
أَبَدًا ۝

وَكَذَلِكَ أَعْتَرْنَا عَلَيْهِمْ لِيَعْلَمُوا أَنَّ وَعْدَ  
اللَّهِ حَقٌّ وَ أَنَّ السَّاعَةَ لَا رَيْبَ فِيهَا ۗ  
إِذْ يَتَنَزَّعُونَ بَيْنَهُمْ أَمْرَهُمْ فَقَالُوا ابْنُوا  
عَلَيْهِمْ بُيُوتًا ۗ رَبُّهُمْ أَعْلَمُ بِهِمْ ۗ قَالَ  
الَّذِينَ غَلَبُوا عَلَىٰ أَمْرِهِمْ لَنَتَّخِذَنَّ  
عَلَيْهِمْ مَّسْجِدًا ۝

سَيَقُولُونَ ثَلَاثَةٌ رَّابِعُهُمْ كَلْبُهُمْ ۗ وَيَقُولُونَ  
خَمْسَةٌ سَادِسُهُمْ كَلْبُهُمْ رَجْمًا بِالْغَيْبِ ۗ  
وَيَقُولُونَ سَبْعَةٌ وَثَامُهُمْ كَلْبُهُمْ ۗ قُلْ

12 يا عباد الجوزف باء الأء بعد الباء من النصف الأول واللام الثانية من النصف الأخير

4. Ky kuptim i fjalës *vel-jetelettaf* është marrë nga fjalori El-Mu'xhemul-Vasit.

dhe i teti ishte qeni i tyre”. Thuaj: Zoti im di më së miri numrin e tyre dhe (përveç Atij) asnjëri nuk di për ta.<sup>5</sup> Andaj, mos diskuto rreth tyre, përveçse sipërfaqësisht dhe mos pyet asnjërin prej tyre për ta.<sup>6</sup>

24. Dhe mos thuaj kurrë për diçka: “Unë kam për ta bërë këtë nesër”,

25. por vetëm nëse do Allahu. Kujto Zotin tënd kur harron dhe thuaj: Shpresoj që Zoti im të më udhëzojë për diçka më të drejtë se kjo.

26. Ata qëndruan në shpellën e tyre treqind vjet dhe shtuan edhe nëntë të tjera.

27. Thuaj: Allahu e di më së miri se sa qëndruan ata. Ai zotëron të padukshmen e qiejve dhe të tokës. Sa mirë sheh dhe sa mirë dëgjon Ai! Ata nuk kanë ndonjë mik tjetër përveç Atij dhe Ai askënd nuk bën ortak në sundimin e Tij.

28. Recito atë që të shpallet ty prej Librit të Zotit tënd. Askush nuk i ndryshon dot fjalët e Tij dhe ti kurrë nuk gjen dot ndonjë strehues përveç Atij.

رَبِّيَ أَعْلَمُ بِحَدِيثِهِمْ مَا يَعْلَمُهُمْ إِلَّا قَلِيلٌ ۗ<sup>٥</sup>  
فَلَا تُنَادِرُ فِيهِمْ إِلَّا مِرَاءً ظَاهِرًا وَلَا  
تَسْتَفْتِي فِيهِمْ مِنْهُمْ أَحَدًا ۖ<sup>٦</sup>

وَلَا تَقُولَنَّ لِشَايٍ إِنِّي فَاعِلٌ ذَٰلِكَ  
عَدًّا ۗ<sup>٧</sup>

إِلَّا أَنْ يَبْشَأَ اللَّهُ ۗ وَادْكُرْ رَبَّكَ إِذْ أَنْسَيْتَ  
وَقُلْ عَسَىٰ أَنْ يَهْدِيَنِّي رَبِّي لِأَقْرَبَ مِنْ  
هَٰذَا رَشْدًا ۖ<sup>٨</sup>

وَلَبِثُوا فِي كَهْفِهِمْ ثَلَاثَ مِائَةٍ سِنِينَ  
وَارْتَادُوا تِسْعًا ۖ<sup>٩</sup>

قَالَ اللَّهُ أَعْلَمُ بِمَا لَبِثُوا ۗ لَهُ غَيْبُ السَّمَوَاتِ  
وَالْأَرْضِ ۗ أَبْصُرْ بِهِ ۗ وَأَسْمِعْ ۗ مَا لَهُمْ مِنْ  
دُونِهِ مِنْ وَلِيٍّ ۗ وَلَا يُشْرِكُ فِي حُكْمِهِ  
أَحَدًا ۖ<sup>١٠</sup>

وَاقْرَأْ مَا أُوحِيَ إِلَيْكَ مِنْ كِتَابِ رَبِّكَ ۗ<sup>١١</sup>  
لَا مُبَدِّلَ لِكَلِمَاتِهِ ۗ وَلَنْ تَجِدَ مِنْ دُونِهِ  
مُلْتَحَدًا ۖ<sup>١٢</sup>

5. Për këtë kuptim të fjalëve “*il-lā kalīl*”, shikoni fjalorin Akrab.

6. Ka rrëfime të ndryshme për numrin e banorëve të shpellës, por në çdo rrëfim përmendet edhe një qeni i tyre. Popujt e sotëm të krishterë në përgjithësi e duan qenin si kafshë shtëpiake, por ndoshta nuk e dinë se cila është arsyeja. Bibla nuk flet për këtë, por Kurani i Shenjtë tregon që të krishterët e parë për një kohë të gjatë e mbanin qenin për mbrojtjen e tyre. Prandaj, ishte e natyrshme që ata si popull ta donin shokun e tyre besnik. Për sa i përket numrit të tyre, Zoti i Madhërishëm e njoftoi Profetin Muhammed<sup>saws</sup> që askujt nuk i është dhënë dijëni e detajuar në lidhje me ta, andaj edhe ti mos u fut në debate të thella për ta.

29. Duro edhe vetë, bashkë me ata që i luten Zotit të tyre, edhe në mëngjes, edhe në darkë, duke kërkuar pëlqimin e Tij. Shikimi yt le të mos i tejkalojë ata, duke kërkuar zbukurimin e jetës së kësaj bote. Mos ndiq atë të cilit ia kemi bërë zemrën të shkujdesur ndaj kujtimit Tonë dhe që ndoqi dëshirat e tij; çështja e tij i ka kaluar kufijtë.

30. Thuaj: E vërteta është ajo që është prej Zotit tuaj. Prandaj, kush të dojë le të besojë dhe kush të dojë le të mohojë. Ne kemi përgatitur për keqbërësit një zjarr, caqet e të cilit do t'i rrethojnë ata. Nëse ata do të kërkojnë ujë, do t'u jepet një ujë që i ngjan bakrit të shkrirë që do t'ua përcëllojë fytyrat. Sa e keqe është kjo pije dhe sa i keq ky vendpushim!

31. Ata që besuan dhe bënë të mira (le të dëgjojnë), Ne kurrë nuk ia humbim shpërblimin atij që bën punë të mirë.

32. Pikërisht këta do të kenë kopshte të përhershme, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Në to ata do të stolisen me byzylykë ari dhe do të veshin rroba të gjelbra prej mëndafshi të hollë e mëndafshi të trashë. Në to do të ulen të mbështetur në jastëk. Sa i mirë është ky shpërblim dhe sa i bukur ky vendpushim!

33. Dhe jepu atyre shembullin e dy burrave, njërit prej të cilëve i bëmë dy kopshte vreshtash rrushi,

وَاصْبِرْ نَفْسَكَ مَعَ الَّذِينَ يَدْعُونَ رَبَّهُمْ بِالْعَدْوَةِ وَالْعَشِيِّ يُرِيدُونَ وَجْهَهُ وَلَا تَعْدُ عَيْنُكَ عَنْهُمْ تُرِيدُ زِينَةَ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَلَا تُطِعْ مَنْ أَغْفَلْنَا قَلْبَهُ عَن ذِكْرِنَا وَاتَّبَعَ هَوَاهُ وَكَانَ أَمْرُهُ فُرُطًا ۝

وَقُلِ الْحَقُّ مِن رَّبِّكُمْ ۖ فَمَن شَاءَ فَلْيُؤْمِنْ وَمَن شَاءَ فَلْيُكْفُرْ ۗ إِنَّا أَعْتَدْنَا لِلظَّالِمِينَ نَارًا ۗ أَحَاطَ بِهُمْ سُرَادِقُهَا ۗ وَإِن يَسْتَعِيضُوا يِعَاثُوا بِمَاءٍ كَالْمُهْلِ يَشْوِي الْوُجُوهَ ۗ بِئْسَ الشَّرَابُ ۗ وَسَاءَتْ مَرْتَفَقًا ۝

إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ إِنَّا لَا نُضِيعُ أَجْرَ مَنْ أَحْسَنَ عَمَلًا ۝

أُولَٰئِكَ لَهُمْ جَنَّاتٌ عَدْنٍ تَجْرِي مِن تَحْتِهِمُ الْأَنْهَارُ يُحَلَّوْنَ فِيهَا مِنْ أَسَاوِرَ مِن ذَهَبٍ وَيَلْبَسُونَ ثِيَابًا خُضْرًا مِّن سُنْدُسٍ وَاسْتَبْرَقٍ مُّتَّكِئِينَ فِيهَا عَلَى الْأَرَائِكِ ۗ نِعْمَ الثَّوَابُ ۗ وَسَاءَتْ مَرْتَفَقًا ۝

وَاصْرِبْ لَهُم مَّثَلًا رَّجُلَيْنِ جَعَلْنَا لِأَحَدِهِمَا جَنَّتَيْنِ مِنْ أَعْنَابٍ وَحَفَفْنَاهُمَا

i rrethuan ato me hurma dhe bëmë edhe arë mes tyre.

بِخُلٍ وَجَعَلْنَا بَيْنَهُمَا زُرْعًا ﴿٣٣﴾

34. Të dyja kopshtet jepnin frytin e tyre dhe nuk pakësonin asgjë prej tij. Dhe Ne hapëm edhe kanale uji mes tyre.

كَلَّمَا الْجَنَّتَيْنِ اِتَتْ اُكْلَهَا وَلَمْ تَتْلَمَّ مِنْهُ شَيْئًا<sup>١</sup> وَفَجَّرْنَا خِلْفَهُمَا نَهْرًا ﴿٣٤﴾

35. Ai kishte shumë fruta. Atëherë i tha shokut të tij duke debatuar me të: “Unë kam më shumë pasuri se ti dhe jam më i fuqishëm edhe në numër.”

وَكَانَ لَهُ ثَمَرٌ فَقَالَ لِصَاحِبِهِ وَهُوَ يُحَاوِرُهُ اَنَا اَكْثَرُ مِنْكَ مَالًا وَاَعَزُّ نَفَرًا ﴿٣٥﴾

36. Ai hyri në kopshtin e tij, ndërkohë ishte keqbërës ndaj vetvetes, tha: “Nuk besoj se do të shkatërrohet kjo ndonjëherë;

وَدَخَلَ جَنَّتَهُ وَهُوَ ظَالِمٌ لِّنَفْسِهِ<sup>٢</sup> قَالَ مَا اُظُنُّ اَنْ تَبِيدَ هَذِهِ اَبَدًا ﴿٣٦﴾

37. dhe as nuk besoj që do të ngrihet Kiameti; edhe nëse do të kthehem te Zoti im, do të gjejë patjetër një vendkthim më të mirë se ky”.

وَمَا اُظُنُّ السَّاعَةَ قَائِمَةً<sup>٣</sup> وَلَئِنْ رُدِدْتُ اِلَى رَبِّي لَاجِدَنَّ خَيْرًا مِنْهَا مُنْقَلَبًا ﴿٣٧﴾

38. Shoku i tij, duke biseduar me të, i tha: “A mohove Atë që të krijoi ty prej dheu, më pas prej sperme, më pas të bëri burrë të plotë?!”

قَالَ لَهُ صَاحِبُهُ وَهُوَ يُحَاوِرُهُ اَكَفَرْتَ بِالَّذِي خَلَقَكَ مِنْ تُرَابٍ ثُمَّ مِنْ نُطْفَةٍ ثُمَّ سَوَّكَ رَجُلًا ﴿٣٨﴾

39. Por (unë them se<sup>7</sup>) pikërisht Ai Allah është Zoti im dhe unë nuk bëj askënd ortak me Zotin tim.

لَكِنَّمَا هُوَ اللهُ رَبِّي وَلَا اُشْرِكُ بِرَبِّي اَحَدًا ﴿٣٩﴾

40. E kur hyre në kopshtin tënd, përse nuk the – Kështu ka dashur Allahu; askush nuk ka fuqi përveç Allahut –. Nëse më shikon që jam më i paktë se ti në pasuri dhe fëmijë,

وَلَوْلَا اِذْ دَخَلْتَ جَنَّتَكَ قُلْتَ مَا شَاءَ اللهُ<sup>٤</sup> لَا قُوَّةَ اِلَّا بِاللّٰهِ<sup>٥</sup> اِنْ تَرٰنِ اَنَا اَقَلُّ مِنْكَ مَالًا وَاَوْلَدًا ﴿٤٠﴾

7. Ky kuptim është marrë nga Tefsir Rühul-Meānī.

41. mundet që Zoti im të më japë (diçka) më të mirë se kopshti yt, kurse atij (kopshtit tënd) t'i dërgojë një ndëshkim llogarimarrës prej qiellit dhe ai të përfundojë në një tokë të tharë, të lëmuar.

42. Ose t'i shterojë uji, që ti kurrë të mos kesh mundësi ta tërheqësh atë.”<sup>8</sup>

43. Fruta e tij u rrethua (nga gjëma) dhe ai mbeti duke fërkuar duart mbi atë që kishte shpenzuar në to, kurse ato (vreshta) bashkë me mbajtëset e tyre kishin rënë përtokë dhe ai thoshte: “Mjerë unë! Sikur të mos kisha bërë askënd ortak me Zotin tim!”

44. Ai as nuk kishte ndonjë grup që ta ndihmonin përballë Allahut dhe as nuk u bë dot hakmarrës.

45. Aty pushteti ishte i Allahut, të Vërtetit. Ai është i mirë në shpërblim dhe i mirë në përfundim.

46. Jepu atyre shembullin e jetës së kësaj bote që është si i ujit që zbritëm prej qiellit, me të cilin u përzejë bimësia e tokës, atëherë ai u bë byk, që e marrin erërat. Allahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë.

47. Pasuria dhe fëmijët janë bukuria e jetës së kësaj bote dhe veprat e mira që qëndrojnë janë më të mira në shpërblim pranë Zotit tënd dhe më të mira në shpresë.

8. Shterimi i ujit do të thotë edhe ndërprerja e komunikimit me Zotin.

فَعَسَىٰ رَبِّيٰ أَنْ يُؤْتِيَنِي خَيْرًا مِّنْ جَنَّتِكَ  
وَيُرْسِلَ عَلَيْهَا حُسْبَانًا مِّنَ السَّمَاءِ فَتُصْبِحُ  
صَعِيدًا زَلَقًا ۝٤١

أَوْ يُصْبِحَ مَأْوَاهَا غَوْرًا فَلَنْ تَسْتَطِيعَ  
لَهُ طَلَبًا ۝٤٢

وَأَحِيطَ بِثَمَرِهِ فَأَصْبَحَ يُقَلِّبُ كَفَيْهِ عَلَىٰ  
مَا أَنْفَقَ فِيهَا وَهِيَ خَاوِيَةٌ عَلَىٰ عُرُوشِهَا  
وَيَقُولُ لِيَأْتِنِي لِمَ أَشْرِكُ بِرَبِّي أَحَدًا ۝٤٣

وَلَمْ تَكُنْ لَهُ فِئَةٌ يَنْصُرُونَهُ مِنْ دُونِ اللَّهِ  
وَمَا كَانَ مُنتَصِرًا ۝٤٤

هُنَالِكَ الْوَلَايَةُ لِلَّهِ الْحَقِّ ۗ هُوَ خَيْرٌ ثَوَابًا  
وَخَيْرٌ عُقْبًا ۝٤٥

وَاضْرِبْ لَهُم مَّثَلِ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا كَمَا  
أَنْزَلْنَاهُ مِنَ السَّمَاءِ فَاخْتَلَطَ بِهِ نَبَاتُ  
الْأَرْضِ فَأَصْبَحَ هَشِيمًا تَذْرُوهُ الرِّيحُ ۗ  
وَكَانَ اللَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ مُّقْتَدِرًا ۝٤٦

أَمْالٌ وَالْبَنُونَ زِينَةُ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا  
وَالْبَقِيَّةُ الصَّالِحَاتُ خَيْرٌ عِنْدَ رَبِّكَ ثَوَابًا  
وَخَيْرٌ أَمَلًا ۝٤٧



48. Ditën kur Ne do të lëvizim malet dhe ti do të shohësh tokën të zhveshur dhe Ne do t'i mbledhim ata, duke mos lënë askënd të mungojë.

وَيَوْمَ نُسِيرُ الْجِبَالَ وَتَرَى الْأَرْضَ بَارِزَةً ۗ  
وَحَسْرَتُهُمْ فَلَمْ يَغَادِرْ مِنْهُمْ أَحَدًا ۙ

49. Ata do të paraqiten të rreshtuar para Zotit tënd: Ja Na keni ardhur, siç ju krijuam për herë të parë, por ju mendonit që Ne nuk do të linim për ju një ditë të premtuar.

وَعَرَضُوا عَلَى رَبِّكَ صَفًّا لَقَدْ جِئْتُمُونَا  
كَمَا خَلَقْنَاكُمْ أَوَّلَ مَرَّةٍ ۗ بَلْ زَعَمْتُمْ  
أَنَّ نَحْنُ لَنَجْعَلَ لَكُمْ مَوْعِدًا ۙ

50. Do të vendoset Libri dhe ti do të shohësh fajtorët të frikësuar prej asaj që do të gjendet në të dhe ata do të thonë: Mjerë për ne! Ç'është ky Libër që nuk lëshon asnjë gjë të vogël e as të madhe, pa e numëruar!" Pra, ata do të gjejnë të pranishme gjithçka që punuan dhe Zoti yt nuk do t'i bëjë padrejtësi askujt.

وَوُضِعَ الْكِتَابُ فَتَرَى الْمُجْرِمِينَ  
مُسْتَفْقِينَ ۖ فِيهِ وَيَقُولُونَ يُؤْيَلْنَا  
مَالِ هَذَا الْكِتَابِ لَا يُغَادِرُ صَغِيرَةً وَلَا  
كَبِيرَةً إِلَّا أَحْصَاهَا ۗ وَوَجَدُوا مَا عَمِلُوا  
حَاضِرًا ۗ وَلَا يُظْلَمُ رَبُّكَ أَحَدًا ۙ

51. Dhe kur u thamë engjëjve: "Bëni sexhde për Ademin!", ata bënë sexhden, por djalli<sup>9</sup> jo. Ai ishte prej xhindëve, ndaj, shkeli urdhrin e Zotit të tij. Atëherë, a do t'i merrni për miq atë dhe pasardhësit e tij duke Më lënë Mua?! Ndërkohë ata ju kanë armiq! Sa i keq është shpërblimi i keqbërësve!

وَإِذْ قُلْنَا لِلْمَلَكَةِ اسْجُدُوا لِآدَمَ فَسَجَدُوا  
إِلَّا إِبْلِيسَ ۗ كَانَ مِنَ الْجِنِّ فَفَسَقَ عَنْ  
أَمْرِ رَبِّهِ ۗ أَفَتَتَّخِذُونَهُ وَذُرِّيَّتَهُ أَوْلِيَاءَ  
مِنْ دُونِي وَهُمْ لَكُمْ عَدُوٌّ ۗ بِئْسَ  
لِلظَّالِمِينَ بَدَلًا ۙ

52. Unë nuk i kam bërë ata dëshmitarë të krijimit të qiejve dhe të tokës, madje as të krijimit të tyre dhe as nuk jam i tillë që të marr përkrahës ata që shpien në humbje.

مَا أَشْهَدْتُهُمْ خَاقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ  
وَلَا خَاقَ أَنْفُسِهِمْ ۗ وَمَا كُنْتُ مَتَّخِذَ  
الْمُضِلِّينَ عَضُدًا ۙ

9. Iblisi.

53. Ditën kur Ai do të thotë: Thirrini ata që mendonit se ishin ortakë me Mua. Atëherë ata do t'u luten atyre, por ata nuk do t'u përgjigjen. Ne do të vëmë një ndarje shkatërrimtare.

وَيَوْمَ يَقُولُ شُرَكَائِي الَّذِينَ  
رَعَمْتُمْ فَدَعَوْهُمْ فَلَمْ يَسْتَجِيبُوا لَهُمْ  
وَجَعَلْنَا بَيْنَهُم مَّوْبِقًا ﴿٣٧﴾

54. Fajtorët do ta shikojnë zjarrin dhe do të kuptojnë se ata do të bien në të dhe nuk do të gjejnë asnjë rrugë shpëtimi prej tij.

وَرَأَى الْمُجْرِمُونَ النَّارَ فَظَنُّوا أَنَّهُمْ  
مُوقِعُوهَا وَلَمْ يَجِدُوا عَنْهَا مَصْرِفًا ﴿٣٨﴾

55. Ne shpjeguar në mënyrë të përsëritur në këtë Kuran çdo shembull për njerëzit. Njeriu është grindavec më shumë se çdo gjë.

وَلَقَدْ صَرَّفْنَا فِي هَذَا الْقُرْآنِ لِلنَّاسِ  
مِنْ كُلِّ مَثَلٍ ۗ وَكَانَ الْإِنْسَانُ أَكْثَرَ شَيْءٍ  
جَدَلًا ﴿٣٩﴾

56. Asgjë nuk i ndaloi njerëzit të besonin kur u erdhi udhëzimi dhe t'i kërkonin falje Zotit të tyre, përveçse (donin) që atyre t'u përsëritej historia e të parëve ose t'i zinte ndëshkimi i vrullshëm.

وَمَا مَنَعَ النَّاسَ أَنْ يُؤْمِنُوا إِذْ جَاءَهُمْ  
الْهُدَىٰ وَيَسْتَغْفِرُوا رَبَّهُمْ إِلَّا أَنْ تَأْتِيَهُمْ  
سُنَّةٌ الْأُولَىٰ أَوْ يَأْتِيَهُمُ الْعَذَابُ قُبُلًا ﴿٤٠﴾

57. Dhe Ne nuk dërgojmë të Dërguarit përveçse si sihariqdhënës dhe alarmues. Ata që mohuan, grinden duke u mbështetur tek e rrema, që përmissaj ta kundërshtojnë të vërtetën. Ata i morën për tallje shenjat e Mia, si dhe paralajmërimet që u ishin bërë.

وَمَا نُرْسِلُ الْمُرْسَلِينَ إِلَّا مُبَشِّرِينَ  
وَمُنذِرِينَ ۗ وَيُجَادِلُ الَّذِينَ كَفَرُوا  
بِالْبَاطِلِ لِيُدْحِضُوا بِهِ الْحَقَّ وَاتَّخَذُوا  
آبَتِي وَمَا أُنذِرُوا هُرُوقًا ﴿٤١﴾

58. Kush mund të jetë më keqbërës se ai të cilit iu kujtuan ajetet e Zotit të tij, por ai u shmang prej tyre dhe e harroi atë që duart e tij e çuan përpara?! Njëmend, Ne vumë perde mbi zemrat e tyre që ata të mos e kuptojnë, dhe barrë në veshët e tyre. Edhe nëse i thërret drejt udhëzimit,

وَمَنْ أَظْلَمُ مِمَّنْ ذُكِّرَ بِآيَاتِ رَبِّهِ  
فَأَعْرَضَ عَنْهَا وَنَسَىٰ مَا قَدَّمَتْ يَدُهُ ۗ إِنَّا  
جَعَلْنَا عَلَىٰ قُلُوبِهِمْ أَكِنَّةً أَنْ يَفْقَهُوهُ

prapëseprapë ata kurrë nuk do të udhëzohen.

وَفِي آذَانِهِمْ وَقْرًا وَإِنْ تَدْعُهُمْ إِلَى  
الْهُدَى فَلَنْ يَهْتَدُوا إِذًا أَبَدًا ﴿٥٨﴾

59. Zoti yt është Falësi, zotëruesi i mëshirës. Po t'i zërë ata për atë që punuan, do t'ua shpejtonte ndëshkimin, por ka një afat të caktuar për ta, nga i cili ata nuk do të kenë rrugëdalje.

وَرَبُّكَ الْغَفُورُ ذُو الرَّحْمَةِ لَوْ يُؤَاخِذُهُمْ  
بِمَا كَسَبُوا لَعَجَّلَ لَهُمُ الْعَذَابَ بَلْ لَهُمْ  
مَوْعِدٌ لَنْ يَجِدُوا مِنْ دُونِهِ مَوْيِلًا ﴿٥٩﴾

60. Këto janë fshatra që Ne i shkatërruam kur ata bënë të këqija. Për shkatërrimin e tyre kemi lënë një afat të caktuar.

وَتِلْكَ الْقُرَىٰ أَهْلَكْنَاهُمْ لَمَّا ظَلَمُوا  
وَجَعَلْنَا لِمَهْلِكِهِمْ مَوْعِدًا ﴿٦٠﴾

61. Dhe kur Musai i tha shokut të tij të ri: “Nuk do të ndalem gjersa të arrij vendin e bashkimit të dy deteve, ose do të eci për shekuj me radhë.”<sup>10</sup>

وَإِذْ قَالَ مُوسَىٰ لِقُنُوءِهِ لَا أَبْرَحَ حَتَّىٰ  
أَبْلُغَ مَجْمَعَ الْبَحْرَيْنِ أَوْ أَمْضِيَ حُقُبًا ﴿٦١﴾

62. Kur ata të dy arritën te bashkimi i tyre, harruan peshkun e tyre, dhe ai u përvodh duke marrë rrugën e tij për në det.<sup>11</sup>

فَلَمَّا بَلَغَا مَجْمَعَ بَيْنَهُمَا نَسِيَا حُوتَهُمَا  
فَاتَّخَذَ سَبِيلَهُ فِي الْبَحْرِ سَرَبًا ﴿٦٢﴾

10. Historitë që përmenden në Kuranin e Shenjtë nuk janë thjesht histori, por çdo ngjarje e përmendur mbart një profeci dhe simbolikë me vete. Edhe kjo ngjarje nuk është thjesht histori. Me djalin e ri që përmendet me *Hazret Musai*<sup>as</sup> nënkuptohet *Hazret Isai*<sup>as</sup>. Kjo ngjarje flet për kohën në të cilën po i vinte fundi epokës së *Hazret Musait*, dhe fillimi i epokës së *Hazret Profetit Muhammed*<sup>savs</sup>. Pavarësisht se mes të dyve përmendet edhe *Hazret Isai*<sup>as</sup>, por ai është ndjekës i *Hazret Musait*<sup>as</sup>.

11. Ajetet 61 – 62 tregojnë një *keshf* (vizion) të *Hazret Musait*<sup>as</sup>, në të cilin ai pa *Isain*<sup>as</sup>, Mesihun që do të shfaqej në *umetin* e tij. Peshku nënkupton mësimin shpirtëror që është ushqim për shpirtin. Vendi ku bashkohen dy dete simbolizon kapërcyellin e *umetit* të *Musait*<sup>as</sup> dhe fillimin e *umetit* të Profetit Muhammed<sup>savs</sup>. Pra, *umeti* i *Musait*<sup>as</sup>, bashkë me Mesihun dhe ndjekësit e tij, do të vijonte deri në kohën e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, por përpara kësaj, të krishterët do ta humbnin rrugën e drejtë, siç tregojnë edhe fjalët që atyre u iku nga dora peshku i tyre. Në librin e famshëm të interpretimit të ëndrrave, thuhet se një nga kuptimet e peshkut në ëndërr ose në *keshf* është “*faltorja e njerëzve të dëlirë dhe xhamia e adhuruesve të shqertë*” (Ta’tirul-enam, nën fjalën حوت). Kështu që, pas ikjes së *peshkut* të tyre, do të fillonte epoka e Profetit të Premtuar, pra e *Hazret Muhammedit*<sup>savs</sup>. Ky ishte një lloj *mi’raxhi* i *Hazret Musait*<sup>as</sup>, në të cilin

63. Dhe kur kapërcyen, ai i tha shokut të tij të ri: “Na sill bukën tonë. Na ka prekur lodhja nga ky udhëtim yni.”

64. (I riu) tha: “Kur u strehuam te shkëmbi, a ke parë që e kam humbur peshkun? Mua nuk më bëri tjetërkush përveç djallit që ta harroja dhe të mos e kujtoja atë. Ai mori rrugën e tij për në det në mënyrë të çuditshme.”<sup>12</sup>

65. (Musai) tha: “Këtë e kërkonim ne.” Atëherë ata u kthyen duke ndjekur gjurmët e këmbëve të tyre.<sup>13</sup>

66. Atëherë ata gjetën njërin prej robërve Tanë, të cilit i kishim dhënë mëshirë prej Vetes dhe i kishim mësuar nga ana Jonë dijen.<sup>14</sup>

67. Musai i tha atij: “A mund të të ndjek që të më mësosh diçka nga udhëzimi që je mësuar ti?”

68. Ai tha: “Ti nuk mund të kesh durim me mua.

69. Dhe si mund të durosh për diçka që nuk ke dije rreth saj.”

فَلَمَّا جَاوَزَا قَالَ لِفَتَاهُ إِنِّي جَدَّاءَنَا  
لَقَدْ لَقِينَا مِنْ سَفَرِنَا هَذَا نَصَبًا ﴿١٣﴾

قَالَ أَرَأَيْتَ إِذْ أَوَيْنَا إِلَى الصَّخْرَةِ فَإِنِّي  
نَسِيتُ الْحُوتَ وَمَا أَنسِينِيهِ إِلَّا الشَّيْطَانُ  
أَنْ أَذْكُرَهُ ۚ وَاتَّخَذَ سَبِيلَهُ فِي الْبَحْرِ  
عَجَبًا ﴿١٤﴾

قَالَ ذَلِكَ مَا كُنَّا نَبْغِ ۚ فَارْتَدَّا عَلَى  
أَثَارِهِمَا قَصَصًا ﴿١٥﴾

فَوَجَدَا عَبْدًا مِنْ عِبَادِنَا آتَيْنَاهُ رَحْمَةً  
مِنْ عِنْدِنَا وَعَلَّمْنَاهُ مِنْ لَدُنَّا عِلْمًا ﴿١٦﴾

قَالَ لَهُ مُوسَى هَلْ اتَّبَعَكَ عَلَى أَنْ  
تُعَلِّمَنِي مِمَّا عَلَّمْتَ رُسُلًا ﴿١٧﴾

قَالَ إِنَّكَ لَنْ تَسْتَطِيعَ مَعِيَ صَبْرًا ﴿١٨﴾

وَكَيفَ تَصْبِرُ عَلَى مَا لَمْ تُحِطْ بِهِ خُبْرًا ﴿١٩﴾

Zoti ia tregoi edhe pasardhësin e tij të fundit, Hazret Isain<sup>as</sup>, gjithashtu edhe të ngjashmin e tij, pra Profetin Muhammed<sup>savs</sup>, i cili do të ishte më i madh në grada sesa Hazret Musai<sup>as</sup>.

12. Një popull në kamje, nëse jepet pas rehatisë, ai e humb qëllimin e vërtetë të adhurimit.

13. Pra, lanë pas profeci të shumta të cilat do të vërtetonin ardhjen e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, në mënyrë që popujt e atyre të dyve (i Musait<sup>as</sup> dhe i Isait<sup>as</sup>) të mos gabonin për ta gjetur atë.

14. Fjalët *njëri prej robërve Tanë* nënkupton Profetin Muhammed<sup>savs</sup> që Allahu ia tregoi Hazret Musait<sup>as</sup>.

70. (Musai) tha: “Nëse do Allahu, do të më gjesh të duruar dhe unë nuk do të të bëhem mosbindës në asnjë çështje.”

71. Ai tha: “Nëse më ndjek mua, nuk duhet të më pyesësh për asgjë, gjersa unë vetë të të them diçka nga ajo.”

72. Atëherë ata u nisën. Derisa hipën në anije, të cilën (më pas) ai e çau. (Musai) tha: “A e çave që udhëtarët e saj të mbyten? Ke bërë një gjë shumë të keqe!”

73. Ai tha: “A nuk të thashë që nuk mund të kesh durim me mua?!”

74. (Musai) tha: “Mos më qorto për atë që kam harruar dhe mos më shtrëngo duke më vështirësuar çështjen.”

75. Atëherë ata u nisën, gjersa takuan një djalë, të cilin ai e vrau. (Musai) tha: “A e vrave një shpirt të pafajshëm, që nuk i kishte marrë jetë njeriu?! Ke bërë një gjë të urryer!”<sup>15</sup>

76. Ai tha: “A nuk të thashë që nuk mund të kesh durim me mua?!”

77. (Musai) tha: “Po të pyeta për ndonjë gjë pas kësaj, mos u shoqëro më me mua. Njëmend, tashmë të kam dhënë arsyë.”

قَالَ سَتَدِينِي إِن شَاءَ اللَّهُ صَابِرًا وَلَا أَعْصِي لَكَ أَمْرًا ۝٧٠

قَالَ فَإِنِ اتَّبَعْتَنِي فَلَا تَسْأَلْنِي عَنْ شَيْءٍ حَتَّىٰ أُحَدِّثَ لَكَ مِنْهُ ذِكْرًا ۝٧١

فَانطَلَقَا ۗ حَتَّىٰ إِذَا رَكِبَا فِي السَّفِينَةِ خَرَقَهَا ۖ قَالَ أَخَرَقْتَهَا لِتُغْرِقَ أَهْلَهَا ۚ لَقَدْ جِئْتَ شَيْئًا إِمْرًا ۝٧٢

قَالَ أَلَمْ أَقُلْ لئن تَسْتَطِيعَ مَعِيَ صَبْرًا ۝٧٣

قَالَ لَا تَأْخُذْنِي بِمَا نَسِيتُ وَلَا تُرْهِقْنِي مِنْ أَمْرِي عُسْرًا ۝٧٤

فَانطَلَقَا ۗ حَتَّىٰ إِذَا نَفِيَا غُلَمًا فَفَقَتْهُ ۗ قَالَ أَقْتَلْتَنِي نَفْسًا زَكِيَّةً بِغَيْرِ نَفْسٍ ۗ لَقَدْ جِئْتَ شَيْئًا نُكْرًا ۝٧٥

قَالَ أَلَمْ أَقُلْ لئن تَسْتَطِيعَ مَعِيَ صَبْرًا ۝٧٦

قَالَ إِن سَأَلْتُكَ عَنْ شَيْءٍ بَعْدَهَا فَلَا تُصَحِّبْنِي ۚ قَدْ بَلَغْتَ مِنْ لَدُنِّي عُذْرًا ۝٧٧

15. Djalë në ëndërr, ndër të tjera, ka edhe kuptimin e energjisë së papërmbyajtshme, dhe në këtë aspekt, ajeti nënkupton se Libri i Muhammedit<sup>savs</sup> do t'i ndalonte *umetit* të tij gjërat që shkaktojnë energji të tilla të papërmbyajtshme, siç janë alkooli, bixhozi etj..

78. Atëherë ata u nisën, gjersa erdhën pranë banorëve të një fshati, të cilëve u kërkuan ushqim. Por ata refuzuan t'i mirëprisnin. Atje ata panë një mur që ishte gati të rrëzohej. Ai e ngriti atë. (Musai) tha: “Po të doje, mund të merrje ndonjë shpërblim për këtë!”

فَانطَلَقَا <sup>٧٦</sup> حَتَّىٰ اِذَا اَتَيَا اَهْلَ قَرْيَةٍ  
اسْتَظَمَّ اَهْلُهَا فَاَبَوْا اَنْ يُصَيِّفُوهُمَا  
فَوَجَدَا فِيهَا جِدَارًا يُرِيدُ اَنْ يَنْتَقِصَ  
فَاَقَامَهُ <sup>٧٧</sup> قَالَ لَوْ شِئْتَ لَتَّخَذْتَ عَلَيْهِ  
اَجْرًا <sup>٧٨</sup>

79. Ai tha: “Këtu ndahemi unë dhe ti. Tani do të tregoj realitetin e asaj, për të cilën nuk ke pasur dot durim.

قَالَ هَذَا فِرَاقُ بَيْنِي وَبَيْنِكَ <sup>٧٩</sup> سَأُنَبِّئُكَ  
بِتَاوِيلِ مَا لَمْ تَسْتَطِعْ عَلَيْهِ صَبْرًا <sup>٨٠</sup>

80. Për sa i përket anijes, ajo ishte e disa të varfërve që punojnë në det. Vendosa ta bëja me të metë, sepse mbrapa tyre (vinte) një mbret, që merr çdo anije duke grabitur.<sup>16</sup>

اَمَّا السَّفِينَةُ فَكَانَتْ لِمَسْكِينٍ يَعْمَلُونَ  
فِي الْبَحْرِ فَاَرَدْتُ اَنْ اَعِيبَهَا وَكَانَ  
وَرَاءَهُمْ مَلِكٌ يَأْخُذُ كُلَّ سَفِينَةٍ غَصْبًا <sup>٨١</sup>

81. Për sa i përket djalit, prindërit e tij ishin besimtarë. Patëm frikë që ai do t'i rëndonte jashtë mase nga rebelimi dhe mosmirënjohja.

وَأَمَّا الْغُلَامُ فَكَانَ أَبُوهُ مَوْمِنِينَ فَخَشِينَا  
اَنْ يُرْهَقَهَا طُغْيَانًا وَكُفْرًا <sup>٨٢</sup>

82. Prandaj, donim që Zoti i tyre t'ua zëvendësonte me një më të mirë se ai, si nga dëlirësia ashtu edhe nga mëshira.

فَاَرَدْنَا اَنْ يُبَدِّلَهَا رَبُّهُمَا خَيْرًا مِنْهُ زَكْوَةً  
وَاقْرَبَ رَحْمًا <sup>٨٣</sup>

83. Dhe sa për murin, ai u përkiste dy djelmohave jetimë në qytet dhe poshtë tij gjendej një thesar për ta, dhe babai i tyre ishte i dëlirë. Zoti yt dëshiroi që ata të dy të arrinin

وَأَمَّا الْجِدَارُ فَكَانَ لِغُلَامَيْنِ يَتِيمَيْنِ فِي  
الْمَدِينَةِ وَكَانَ تَحْتَهُ كَنْزٌ لَهُمَا وَكَانَ  
أَبُوهُمَا صَالِحًا <sup>٨٤</sup> فَآرَادَ رَبُّكَ اَنْ يَبْلُغَا

16. Pronarët e anijes mund të nënkuptojnë muslimanët, dhe çarja e anijes nënkupton që muslimanët do të jepnin zekat nga pasuria e tyre, duke shpenzuar për njerëzit në nevojë. Kurse mbreti mund t'u referohet mbretërve të fuqishëm të kohës, siç ishin Cezari dhe Kisra, të cilët nuk e sulmonin Arabinë duke kujtuar se ajo ishte shkretëtirë dhe e padobishme. Në këtë mënyrë, Allahu e ruajti këtë vend për Profetin Muhammed<sup>savs</sup>.

moshën e pjekurisë dhe ta nxirrnin (vetë) thesarin e tyre; kjo ishte si mëshirë prej Zotit tënd. Dhe unë nuk veprova sipas gjykimit tim. Ky është interpretimi i asaj për të cilën nuk ke pasur dot durim.”<sup>17</sup>

84. Dhe ata të pyesin rreth Dhul-Kernejnit. Thuaj: Patjetër do t’ju tregoj diçka rreth tij.

85. Sigurisht, Ne e fuqizuan atë në tokë dhe atij i dhamë mjetet për çdo gjë.

86. Atëherë, ai ndoqi një rrugë.

87. Gjersa kur mbërriti atje ku perëndon dielli,<sup>18</sup> e gjeti duke perënduar në një burim të përbaltur dhe pranë tij gjeti një popull. Ne i thamë: “O Dhul-Kernejn! Daç ndëshkoji ose daç trajtoji ata me të mirë.”<sup>19</sup>

أَشَدَّهُمَا وَيَسْتَخْرِجَا كَنْزَهُمَا ۖ رَحْمَةً مِّن رَّبِّكَ ۗ وَمَا فَعَلْتُهُ عَنْ أَمْرِي ۗ ذٰلِكَ تَأْوِيلُ ۙ مَا لَمْ تَسْطِعْ عَلَيْهِ صَبْرًا ۙ

وَيَسْأَلُونَكَ عَنِ الذَّرْنَيْنِ ۗ قُلْ سَأَتْلُو عَلَيْكُم مِّنْهُ ذِكْرًا ۙ

إِنَّا مَكَّنَّا لَهُ فِي الْأَرْضِ وَاتَيْنَاهُ مِنْ كُلِّ شَيْءٍ سَبَبًا ۙ

فَاتَّبَعَ سَبَبًا ۙ

حَتَّىٰ إِذَا بَلَغَ مَرْبَبَ الشَّمْسِ وَجَدَهَا تَعْرَبُ فِي عَيْنِ حَمِئَةٍ ۗ وَوَجَدَ عِنْدَهَا قَوْمًا قَلِيلًا يُدَا الْفَرْنَيْنِ ۗ إِمَّا أَنْ تُعَذِّبَ وَإِمَّا أَنْ تَتَّخِذَ فِيهِمْ حُسْنًا ۙ

17. Muri mund të nënkuptojë Profetët e mëdhenj të hebrenjve e të krishterëve, pra Hazret Musain<sup>as</sup> dhe Hazret Isain<sup>as</sup>. Babai i tyre është Hazret Ibrahim<sup>as</sup> dhe thesari është dija shpirtërore që lanë pas njerëzisë e drejtë të Musait dhe të Isait, por për shkak të pakujdesisë së të mëvonshmeve prej popujve të tyre përkatës, kishte rrezik që thesari të shkatërrohej. Atëherë Profeti Muhammed<sup>savs</sup> e siguroi atë, d.m.th., u bë shkak i mbledhjes së mësimëve të Teuratit dhe të Inxhilit në Kuranin e Shenjtë, në mënyrë që kurdo që hebrenjtë dhe të krishterët të ndërgjegjësohen, të përfitojnë prej këtyre mësimëve dhe ta pranojnë Profetin Muhammed<sup>savs</sup>.

18. Vendi ku perëndon dielli tregon pjesën perëndimore të perandorisë së Kirit ose kufirin veriperëndimor të Azisë së Vogël dhe i referohet Detit të Zi, sepse ajo pjesë formonte kufirin veriperëndimor të perandorisë së tij. Ajeti i referohet ekspeditës që Kiri ndërmori kundër armiqve të tij në Perëndim (Enc. Brit.; Historians’ History of the World, nën “Cyrus”).

19. Ajetet 84 – 87: Dhul-Kernejn vjen nga fjala kern. Disa nga kuptimet e kësaj fjale janë: bashkues, bri, skaj, skaji i diskut të diellit që është duke lindur; boria e Ditës së Gjykimit, njeri fisnik, shekull, kohë, epokë, njerëzit e një epoke të caktuar. etj. (Akrab, Lane). Dhe kernejn do të thotë dy kernë. Me Dhul-Kernejnin së pari nënkuptohet Profeti Muhammed<sup>savs</sup>, i cili gjeti kohën e Hazret Musait dhe të popullit të tij nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, po në umetin e tij do të vinte një shërbëtor dhe ndjekës i tij për ringjalljen e umetit të tij. Kështu

88. (Dhul-Kernejni) tha: “Ai që bëri keq, ne patjetër do ta ndëshkojmë, më pas ai do të kthehet te Zoti i tij, atëherë Ai do ta ndëshkojë me një ndëshkim (akoma më) të rëndë.<sup>20</sup>”

قَالَ أَمَّا مَنْ ظَلَمَ فَسَوْفَ نُعَذِّبُهُ ثُمَّ يُرَدُّ  
إِلَىٰ رَبِّهِ فَيُعَذِّبُهُ عَذَابًا ثَكْرًا ﴿٨٧﴾

89. Kurse ai që besoi dhe bëri të mira, shpërblimi i tij është mirësia. Ne do t'i japim me autoritetin tonë lehtësi”.

وَأَمَّا مَنْ آمَنَ وَعَمِلَ صَالِحًا فَلَهُ جَزَاءٌ  
أَحْسَنُ ۖ وَسَقُولُ لَهُ مِنْ أَمْرِنَا يُسْرًا ﴿٨٨﴾

90. Ai sërish ndoqi një rrugë.

ثُمَّ اتَّبَعَ سَبَبًا ﴿٩٠﴾

91. Gjersa kur mbërriti atje ku lind dielli, e gjeti duke lindur mbi një popull, mes të cilit dhe atij (dielli) Ne nuk i bëmë perde.<sup>21</sup>

حَتَّىٰ إِذَا بَلَغَ مَطْلِعَ الشَّمْسِ وَجَدَهَا  
تَظْلَعُ عَلَىٰ قَوْمٍ لَّمْ نَجْعَلْ لَهُم مِّن  
دُونِهَا سِتْرًا ﴿٩١﴾

92. Kështu ndodhi. Dhe Ne përmes dijës i kishim vënë rreth çdo përvoje të tij.

كَذٰلِكَ ۖ وَقَدْ أَحَطْنَا بِمَا لَدَيْهِ خُبْرًا ﴿٩٢﴾

93. Ai sërish ndoqi një rrugë.

ثُمَّ اتَّبَعَ سَبَبًا ﴿٩٣﴾

këto dy periudha i atribuohen vetë Profetit Muhammed<sup>saws</sup> [Lexoni 62:1-5]. Por gjithë kjo profeci është përmendur me një ngjarje të së kaluarës, e cila ndoshta lidhet me mbretin Kir, që përmendet edhe në Bibël. Kiri ishte një njeri me fuqi të jashtëzakonshme shpirtërore dhe ishte edhe monoteist. Këto ajete tregojnë udhëtimet e tij në Lindje e në Perëndim. Për sa i përket ndërtimit të murit, në botë janë ndërtuar disa mure e jo një, të cilat kishin si qëllim mbrojtjen nga sulmet e armikut. Një mur i tillë gjendet në Rusi, e një tjetër në Kinë. Pra, ndërtimi i murit ishte një metodë e atyre kohërave për t'u mbrojtur. Megjithatë, siç e thamë, Kurani i Shenjtë nuk është thjesht një libër historie, por çdo histori e përmendur në të, përmban edhe profeci për të ardhmen.

20. Kiri besonte në jetën pas vdekjes. Ai ishte një ndjekës i Zoroastrit dhe, përveç Islamit, Zoroastrizmi ka vënë theksin më të madh në botën e përtejme. “Pa dyshim, Kiri dhe ndjekësit e tij persë, ashtu si Dariusi (Dari) në një periudhë të mëvonshme, ishin besimtarë të devotshëm të doktrinës së pastër të Zoroastrit dhe i shpërfillnin kultet e huaja”, thuhet në “Jew. Enc.”, vëll. 4, nën “Cyrus”, f. 404.

21. Ajeti i referohet ekspeditës së Kirit në drejtim të Lindjes – në Afganistan dhe Baluçistan, që janë zona shterpe pa pemë, dhe ku dielli e godet tokën drejtpërdrejt. Mund të aplikohet edhe mbi popujt që jetuan në stepat që shtrihen në lindje të Sistanit dhe të Heratit dhe në veri të Duzdabit deri në Mesh’hed.



94. Gjersa kur mbërriti mes dy maleve, përtej tyre gjeti një popull; ata mezi kuptonin ndonjë fjalë.

95. Thanë: “O Dhul-Kernejn! Jexhuxhët e Mexhuxhët bëjnë trazira në tokë, prandaj, a mund të të japim haraç që ti të ndërtosh pengesë mes nesh dhe atyre?”

96. (Dhul-Kernejni) tha: “Ajo (me të cilën) më forcoi Zoti im për këtë është më e mirë. Prandaj, më ndihmoni vetëm përmes forcës; do të ndërtoj një pengesë mes jush dhe atyre.”

97. “Më sillni blloqe hekuri!” Kur ai e rrafshoi vendin mes dy maleve (duke e mbushur atë), tha: “Fryni!”, e kur e bëri zjarr, tha: “Sillmëni bakër, që ta hedh mbi të!”<sup>22</sup>

98. Atëherë ata (pra, Jexhuxhët e Mexhuxhët) as nuk kishin mundësi ta kapërcenin dhe as nuk kishin mundësi ta çanin atë.

99. Ai tha: “Kjo është mëshirë prej Zotit tim. Kur do të vijë premtimi i Zotit tim, do ta bëjë copë-copë. Dhe premtimi i Zotit tim është i vërtetë.”<sup>23</sup>

22. Muri që përmendet në këto ajete (94 – 97) mund të jetë ai që u ndërtoa mes Turqisë e Rosisë, që mbyllte rrugën mes detit Kaspik dhe maleve kaukaziane, mur të cilin e ndërtoi mbreti Kir, që të shpëtonte disa popuj të dobët nga disa popuj perëndimorë. Kiri nuk u kërkoi ndonjë shpërbllim për këtë, por u kërkoi krah pune, hekur dhe bakër. Punimet e ndërtimit i bënë po këta popuj nën udhëzimin e Kirit.

23. Kiri mund të jetë informuar edhe nëpërmjet komunikimit Hyjnor që dikur në të ardhmen, Jexhuxhët dhe Mexhuxhët do të përhapeshin sërish në juglindje të këtij muri, atëherë ky mur do të mbetej jashtë funksionit për t'i penguar ata në përparimin e tyre. Kjo mund të jetë

حَتَّىٰ إِذَا بَلَغَ بَيْنَ السَّدَّيْنِ وَجَدَ مِنْ دُونِهِمَا قَوْمًا لَا يَكَادُونَ يَفْقَهُونَ قَوْلًا ۝٩٤

قَالُوا يَا أَيْنَ الْقَرْنَيْنِ إِنَّ يَأْجُوجَ وَمَأْجُوجَ مُفْسِدُونَ فِي الْأَرْضِ فَهَلْ نَجْعَلُ لَكَ خَرْجًا عَلَىٰ أَنْ تَجْعَلَ بَيْنَنَا وَبَيْنَهُمْ سَدًّا ۝٩٥

قَالَ مَا مَكَّنِّي فِيهِ رَبِّي خَيْرٌ فَأَعِينُونِي بِقُوَّةٍ أَجْعَلْ بَيْنَكُمْ وَبَيْنَهُمْ رَدْمًا ۝٩٦

أَتُونِي زُبَرَ الْحَدِيدِ ۗ حَتَّىٰ إِذَا سَاوَى بَيْنَ الصَّدَفَيْنِ قَالَ انفُخُوا ۗ حَتَّىٰ إِذَا جَعَلَهُ نَارًا ۗ قَالَ أْتُونِي أُفْرِغْ عَلَيْهِ قَطْرًا ۝٩٧

فَمَا اسْطَاعُوا أَنْ يَظْهَرُوهُ وَمَا اسْتَطَاعُوا لَهُ نَقْبًا ۝٩٨

قَالَ هَذَا رَحْمَةٌ مِنْ رَبِّي ۗ فَإِذَا جَاءَ وَعْدُ رَبِّي جَعَلَهُ دَكَّاءَ ۗ وَكَانَ وَعْدُ رَبِّي حَقًّا ۝٩٩

100. Atë ditë Ne do të lëmë disa prej tyre të dallgëzojnë mbi disa të tjerë, do t'i fryhet bririt dhe do t'i tubojmë që të gjithë.<sup>24</sup>

وَتَرَكْنَا بَعْضَهُمْ يَوْمَئِذٍ يَمُوجُ فِي بَعْضٍ  
وَأَنْفَحَ فِي الصُّورِ فَجَمَعَهُمْ جَمْعًا ۝١٠

101. Dhe atë ditë do t'u sjellim mohuesve xhehenemin përballë,

وَعَرَضْنَا جَهَنَّمَ يَوْمَئِذٍ لِلْكَافِرِينَ  
عَرَضًا ۝١١

102. të cilët sytë i kishin pasur në perde ndaj përkujtimit Tim dhe që as nuk mund të dëgjonin.

الَّذِينَ كَانَتْ أَعْيُنُهُمْ فِي غَطَاءٍ عَنْ ذِكْرِي  
وَكَانُوا لَا يَسْتَطِيعُونَ سَمْعًا ۝١٢

domethënia e fjalëve “do ta bëjë copë-copë”. Në 21:97 thuhet se Jexhuxhët dhe Mexhuxhët do të përhapnin rrjetën e tyre në të gjithë botën. Metaforikisht, ‘thyerja e murit’ mund të nënkuptojë rënien e fuqisë politike të Islamit, veçanërisht të turqve në Europë. Në kohën kur Jexhuxhët dhe Mexhuxhët do të dilnin në tokë, mure të tilla nuk do të bënin punë. Kurani i Shenjtë tregon që përhapja dhe shtrirja e Jexhuxhëve dhe e Mexhuxhëve në të gjithë botën do të jetë sikur dallgët e detit. Kjo gjithashtu tregon që pushtimi i tyre do të fillonte me pushtimin e deteve.

24. Në kohën e ngritjes së Jexhuxhëve dhe të Mexhuxhëve, të gjithë popujt e botës do të bashkoheshin, por jo dhe zemrat e tyre. Ky bashkim do të ishte vetëm me anë të teknologjisë. E gjithë bota do të bëhej si një qytet i vetëm. Dhe sipas Biblës, “do të ngrihet një popull kundër një populli tjetër e një mbretëri kundër një mbretërie tjetër e do të ketë uri e tërmete në vende të ndryshme” (Bibla, Mateu 24:7), urrejtja dhe paudhësia do të përhapet në masë. Duket qartë se profecia në fjalë i referohet epokës së sotme. Profeti Muhammed<sup>savs</sup> bëri profecinë se koha e Mesihut të Premtuar do të jetë ajo kur do të shfaqen Jexhuxhët dhe Mexhuxhët. Këto emërtime rrjedhin nga rrënja *exh-xhe* dhe *exhixhen* d.m.th. *flakë, afshi i zjarrit, djegie e fuqishme* (Lisanul-Arab, zëri ج ج). Ky emërtim tregon se këto vende do të përdornin shumë zjarrin apo energjinë dhe luftërat e tyre do të bëheshin përmes armëve zjarri të fuqishme. Siç ndodhi në të dy luftërat botërore kur u lëshua një ferr i vërtetë mbi botën, dhe imagjinata njerëzore dridhet nga shkatërrimi që mund të shkaktojë një luftë e tretë botërore. Emërtimet jexhuxhë dhe mexhuxhë tregojnë se edhe mjetet e transportit të kësaj kohe do të punonin pikërisht përmes *zjarrit* ose lëndëve të ndryshme djegëse. Popujt që do t'i shpiknin këto mjete dhe që do t'i përdornin ato më shumë se kushdo tjetër, u quajtën jexhuxhë e mexhuxhë. Shkurt, ishte e parashikuar prej shekujsh që Mesihu i Premtuar do të shfaqej pikërisht në këtë kohë. Në Kuran dhe në hadithe gjithashtu përmendet që në kohën e Mesihut të Premtuar devetë dhe kafshët e tjera që përdoren për transport, do të dilnin jashtë përdorimit (81:5). Edhe kjo tregon se do të dilnin mjetet më të shpejta të transportit që do t'i zëvendësonin ato. Edhe gomari i Dexhallit qartazi këtë rol do të luante, pra, një gomar që nuk do të hante bar, por zjarr, dhe që do të udhëtonte në tokë, në det dhe në ajër duke mbartur njerëz brenda, me shpejtësi të atillë që jo vetëm popujt e kohës së Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, por as ata që ishin dy shekuj para nesh, as nuk mund ta imagjinonin dot. Lexoni edhe suren 81.

103. A menduan mohuesit se mund të marrin mbrojtës robërit e Mi, duke Më lënë Mua?! Njëmend, Ne u kemi përgatitur mohuesve xhehenemin si pritje.

أَفَحَسِبَ الَّذِينَ كَفَرُوا أَنْ يَتَّخِذُوا  
عِبَادِي مِنْ دُونِي أَوْلِيَاءَ ۗ إِنَّا أَعْتَدْنَا  
جَهَنَّمَ لِلْكَافِرِينَ نُزُلًا ﴿١٠٣﴾

104. Thuaj: A t'ju tregojmë për humbësit më të mëdhenj në vepra?

قُلْ هَلْ نُنَبِّئُكُمْ بِالْأَخْسَرِينَ أَعْمَالًا ﴿١٠٤﴾

105. Janë ata që humbën gjithë mundin e tyre në jetën e kësaj bote dhe mendojnë se po shkëlqejnë në ndërtim.

الَّذِينَ ضَلَّ سَعِيَّهُمْ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا  
وَهُمْ يَحْسَبُونَ أَنَّهُمْ يُحْسِنُونَ صُنْعًا ﴿١٠٥﴾

106. Pikërisht këta janë që mohuan shenjat e Zotit të tyre dhe takimin me Të. Prandaj, veprat e tyre u janë zhvlerësuar dhe, Ditën e Kiametit, Ne nuk do t'u japim kurrfarë vlere.

أُولَٰئِكَ الَّذِينَ كَفَرُوا بِآيَاتِ رَبِّهِمْ وَلِقَائِهِ  
فَحَبِطَتْ أَعْمَالُهُمْ فَلَا تُقِيمُ لَهُمْ يَوْمَ  
الْقِيَامَةِ وَرَنًا ﴿١٠٦﴾

107. Ky është ndëshkimi i tyre, (pra) xhehenemi, për shkak se e mohuan (të vërtetën) dhe i morën për tallje shenjat e Mia dhe të Dërguarit e Mi.

ذَٰلِكَ جَزَاؤُهُمْ جَهَنَّمَ بِمَا كَفَرُوا وَاتَّخَذُوا  
الْبِئْتَىٰ وَرُسُلِي هُرُوقًا ﴿١٠٧﴾

108. Sigurisht, ata që besuan dhe bënë të mira, do të kenë si pritje kopshtet e *Firdeusit*.

إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ كَانَتْ  
لَهُمْ جَنَّاتُ الْفِرْدَوْسِ نُزُلًا ﴿١٠٨﴾

109. Në to do të jenë përgjithmonë. Nuk do të dëshirojnë të ndahen prej tyre.

خَالِدِينَ فِيهَا لَا يَبْغُونَ عَنْهَا حِوَلًا ﴿١٠٩﴾

110. Thuaj: Nëse deti do të ishte bojë shkrimi për fjalët e Zotit tim, deti do të përfundonte përpara se të përfundonin fjalët e Zotit tim, edhe sikur (dete) të tjera si ai të sillnim për ndihmë.

قُلْ لَوْ كَانَ الْبَحْرُ مِدَادًا لِّكَلِمَاتِ رَبِّي  
لَنَفِدَ الْبَحْرُ قَبْلَ أَنْ تَنْفَدَ كَلِمَاتُ رَبِّي  
وَلَوْ جِئْنَا بِمِثْلِهِ مَدَدًا ﴿١١٠﴾

111. Thuaj: Unë pa dyshim jam një njeri si ju. Mua më shpallet që i Adhureshmi juaj është Një i Adhureshëm i Vetëm, andaj, kushdo që dëshiron takimin me Zotin e tij, (edhe ai) le të bëjë vepra të mira dhe të mos shtojë askënd tjetër në adhurimin e Zotit të tij.

قُلْ إِنَّمَا أَنَا بَشَرٌ مِّثْلُكُمْ يُوحَىٰ إِلَيَّ  
 أَنَّمَا إِلَهُكُمُ اللَّهُ وَاحِدٌ فَمَنْ كَانَ يَرْجُوا  
 لِقَاءَ رَبِّهِ فَلْيَعْمَلْ عَمَلًا صَالِحًا وَلَا يُشْرِكْ  
 بِعِبَادَةِ رَبِّهِ أَحَدًا ۝

## Surja 19 – Merjem

Surja Merjem është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka nëntëdhjetë e nëntë ajete. Ajo zbriti në vitin e katërt ose të pestë, përpara se të bëhej mërgimi në Abisini.

Kjo sure flet për lindjen pa baba të *Hazret Isait*<sup>as</sup> dhe thotë se kjo lindje ishte një mrekulli, të cilën bota në atë kohë nuk mund ta kuptonte, por në këtë kohë, edhe vetë studiues të krishterë pohojnë që mund të ndodhë që një e virgjër të lindë fëmijë, pa pasur ndonjë kontakt me një mashkull. Fillimisht mendonin se, në rast të tillë, mund të vijë në jetë vetëm vajzë, por tani kanë provuar se mundet edhe djalë.

Për sa i përket lindjes prej mrekullie, kjo sure pohon se fuqia e Zotit e realizon lindjen edhe nëse çifti kalon moshën kur lindja e fëmijës bëhet e pamundur, madje edhe kur gruaja të jetë shterpë. Me të njëjtën situatë u përballë *Hazret Zekerija*<sup>as</sup>. Ai kishte dëshirë të kishte fëmijë, por vetë ishte kaq i moshuar saqë thuhet “koka ishte ndezur nga thinjat”, kurse gruaja e tij jo vetëm që ishte e moshuar, por edhe shterpë. Kështu që, edhe ky është një shembull i lindjes së fëmijës përmes mrekullisë, që pavarësisht nga këta faktorë, *Hazret Zekerijasë*<sup>as</sup> i lindi *Hazret Jahja*<sup>as</sup>. Dëshira për të pasur një fëmijë të tillë, atij i erdhi pasi meditoi rreth gjendjes së *Hazret Merjemes*<sup>as</sup>, e cila do të lindte *Hazret Isain*<sup>as</sup> pa baba, prej mrekullie.

Më pas përmenden disa detaje se pse *Hazret Merjemja*<sup>as</sup> e la Palestinën dhe shkoi në drejtim të Lindjes për të adhuruar natë e ditë Zotin e Madhërisëm. Pikërisht atje i erdhi lajmi i mirë i djalit, lajm të cilin ia solli një engjëll në formë njeriu.

Pas lindjes kur *Hazret Merjemja* u kthye në Palestinë bashkë me *Hazret Isain*<sup>as</sup>, hebrenjtë e kundërshtuan ashpër dhe thanë se fëmija, *neudhubil-lah*, ishte i jashtëligjshëm. Atëherë Allahu i Madhërisëm e porositi *Hazret Merjemen*<sup>as</sup> që për hir të Zotit, të mbante agjërim për të mos folur, dhe se fëmija (i cili ishte fëmijë djepi, pra 2 a 3 vjeç) vetë do t’u përgjigjej. *Hazret Isai*<sup>as</sup> u tha hebrenjve fjalë të tilla rreth njohjes së Zotit, që një fëmijë i jashtëligjshëm nuk mund t’i konceptonte. Këto fjalë përfshinin edhe profecinë se ai do të bëhej Profet i Zotit dhe gjithashtu që Zoti i Madhërisëm do ta shpëtonte atë nga kurthet dhe atentatet e tyre për ta vvarë atë. Kështu që, thotë:

*“Dhe paqja është mbi mua ditën kur kam lindur, ditën kur do të vdes dhe ditën kur do të ringjallem”.* (19:34)

Një ajet shumë i ngjashëm po në këtë sure vjen edhe për *Hazret Jahjanë*<sup>as</sup>, ku thuhet:

*“Dhe paqe është mbi të ditën kur ka lindur, ditën kur do të vdesë dhe ditën kur do të ringjallet”.* (19:16)

Me këtë ajet, unë [dmth. *Hazret Mirza Tahir Ahmed*<sup>ra</sup>, Kalifi i IV i Xhematit Musliman Ahmedia] mendoj se edhe *Hazret Jahja*<sup>as</sup> nuk është vvarë.

Më pas, duke folur për *Hazret Ibrahimin*<sup>as</sup>, kjo sure përmend fëmijët e tij që kanë lindur përmes mrekullisë. Pra, në një kohë kur *Hazret Ibrahim*<sup>as</sup> ishte plakur, Zoti

i Madhërishëm atij i dhuroi *Hazret Ismailin*<sup>as</sup> dhe *Hazret Is'hakun*<sup>as</sup>, dhe këtij të fundit *Hazret Jakubin*<sup>as</sup>.

Më pas flitet për disa profetë të tjerë, te të cilët shohim aspekte të ndryshme të lindjes shpirtërore. Jepet shembulli i ngritjes së *Hazret Idrisit*<sup>as</sup>, ngjashëm me shembullin e ngritjes së *Hazret Isait*<sup>as</sup>. Këta të gjithë ishin robër të sinqertë të Allahut të Madhërishëm. Pasardhësit e tyre të mëvonshëm nuk e ruajtën këtë dëlirësi, prishën namazet e tyre dhe ndoqën dëshirat vetjake. Për ta ka paralajmërim që ata patjetër do të kenë pasojën e shtrembësisë së tyre.

Kjo sure përmend shpesh atributin *Rrahman* të Zotit. *Rrahman* do të thotë i Gjithëmëshirshëm që dhuron pa kërkuar. Tema e kësaj sureje përputhet pikërisht me kuptimin e këtij atributi.

Në fund të kësaj sureje është pohuar se cilësimi i njerëzve që Zoti i Gjithëmëshirshëm (*Rrahman*) ka djalë, është një mëkat i madh. Thuhet që toka dhe qielli ka mundësi të shpërthejnë nga zemërimi për shkak të këtij besimi të gabuar. Kjo do të thotë se pikërisht njerëzit që kanë këtë besim të gabuar, do të përfshihen në luftëra të tmerrshme, të cilat do të trazojnë tokën dhe qiellin me pasojat e tyre.

Karshi tyre, në ajetet e fundit, flitet për ata që e kanë drojë Zotin dhe bëjnë vepra të mira. Zoti i Gjithëmëshirshëm në zemrat e tyre do të fusë dashurinë e ndërsjellë, dhe jo mërinë dhe urrejtjen që u përmend në ajetet paraardhëse.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. *Kaf.Ha.Ja.Ajn.Sad.* (Ti je i Mjaftueshëm dhe Udhëzues, o i Dijshëm dhe i Vërtetë!)<sup>1</sup>

كَهَيْصًا ②

3. Përmendja e mëshirës së Zotit tënd ndaj robit të Tij, Zekerijasë.

ذَكَرَ رَحْمَتِ رَبِّكَ عَبْدَهُ زَكَرِيَّا ③

4. Kur ai e thirri Zotin e tij me zë të ulët.

إِذْ نَادَى رَبَّهُ نِدَاءً خَفِيًّا ④

5. Tha: “O Zoti im! Eshtrat më janë dobësuar. Koka më është zbardhur nga thinjat, por, o Zoti im, kurrë nuk kam dalë i pafat kur të jam lutur Ty.

قَالَ رَبِّ إِنِّي وَهَنَ الْعَظْمُ مِنِّي  
وَاشْتَعَلَ الرَّأْسُ شَيْبًا وَلَمْ أَكُنْ بِدَعَائِكَ  
رَبِّ شَقِيًّا ⑤

6. Dhe unë kam frikë nga të afërmit e mi pas meje, ndërsa gruan e kam shterpë. Pra, dhuromë prej Teje një trashëgimtar;

وَإِنِّي خِفْتُ الْمَوَالِيَ مِنْ وَرَائِي وَكَانَتِ  
أُمْرَاتِي عَاقِرًا فَهَبْ لِي مِنْ لَدُنْكَ وَلِيًّا ⑥

7. që të më trashëgojë edhe mua dhe të trashëgojë edhe familjen e Jakubit. Dhe, o Zoti im, bëje atë shumë të pëlqyer!”

يُرِيئِي وَيَرِثْ مِنْ آلِ يَعْقُوبَ ۖ وَاجْعَلْهُ  
رَبِّ رَضِيًّا ⑦

8. “O Zekerija! Ne të japim lajmin e mirë të një djali, që do të ketë emrin Jahja; nuk i kemi dhënë këtë emër askujt më parë.”

يُرَكْرِيًا ۖ إِنَّا نُبَشِّرُكَ بِغُلَامٍ اسْمُهُ يَحْيَىٰ ۗ  
لَمْ نَجْعَلْ لَهُ مِنْ قَبْلُ سَمِيًّا ⑧

1. Këto shkurtesa nënkuptojnë أَنْتَ كَافٍ وَهَادٍ يَا عَالِمُ يَا صَادِقُ *Ti je i Mjaftueshëm dhe Udhëzues, o i Dijshëm dhe i Vërtetë!* Më shumë për shkurtesat, lexoni 2:2 dhe 7:2.

9. Ai tha: “O Zoti im! Si mund të kem unë djalë, ndërkohë që gruaja ime është shterpë dhe unë kam kaluar në pleqërinë e skajshme?!”

قَالَ رَبِّ إِنِّي كُنُّنُ فِي عِلْمٍ وَكَانَتْ أُمْرَاتِي  
عَاقِرًا وَفَدَّ بَلَعْتُ مِنَ الْكِبَرِ عِتْيًا ①

10. “Kështu është”, tha ai. Zoti yt tha: “Kjo është e lehtë për Mua. Edhe ty të kam krijuar më parë, kur ti ishe asgjë.”

قَالَ كَذَلِكَ ۚ قَالَ رَبُّكَ هُوَ عَلَىٰ هَٰئِنٍ  
وَقَدْ خَلَقْتَكُ مِنْ قَبْلُ وَلَمْ تَكُ شَيْئًا ①

11. (Zekerija) tha: “O Zoti im! Caktomë ndonjë shenjë.” Ai tha: “Shenja jote është të mos u flasësh njerëzve tri net rresht.”

قَالَ رَبِّ اجْعَلْ لِي آيَةً ۗ قَالَ آيَتُكَ الْأَىٰ  
تُكَلِّمُ النَّاسَ لَيْلٍ سَوِيًّا ①

12. Atëherë ai doli nga mihrabi para popullit të tij, u tha me shenjë: “Përkujtoni Zotin në mëngjes e në mbrëmje.”

فَخَرَجَ عَلَىٰ قَوْمِهِ مِنَ الْمِحْرَابِ فَأَوْحَىٰ  
إِلَيْهِمْ أَنْ سَبِّحُوا بُكْرَةً وَعَشِيًّا ①

13. “O Jahja! Kape Librin fuqimisht!” Ne ia dhamë urtësinë që në vogëli.

يُحْيِي خُذِ الْكِتَابَ بِقُوَّةٍ ۗ وَآتَيْنَاهُ الْحِكْمَ  
صَبِيًّا ①

14. Gjithashtu (i dhuruam) prej Vetes butësinë dhe dëlirësinë. Ai ishte i vetëpërbajtur;

وَحَنَانًا مِّنْ لَّدُنَّا وَزَكَاةً ۗ وَكَانَ تَقِيًّا ①

15. i sjellshëm ndaj prindërve të tij dhe kurrë nuk ishte i rreptë (ose) i pabindur.

وَبَرًّا بِوَالِدَيْهِ وَلَمْ يَكُنْ جَبَّارًا عَصِيًّا ①

16. Dhe paqe ishte mbi të ditën kur lindi, ditën kur do të vdesë dhe ditën kur do të ringjallet.

وَسَلَّمَ عَلَيْهِ يَوْمَ وُلِدَ وَيَوْمَ يَمُوتُ وَيَوْمَ  
يُجَعِّثُ حَيًّا ①

17. Dhe përmende në (këtë) Libër Merjemen; kur ajo u largua nga familja e saj në drejtim të lindjes.

وَأذْكَرُ فِي الْكِتَابِ مَرِيَمَ ۗ إِذِ انْتَبَذَتْ مِنْ  
أَهْلِهَا مَكَانًا شَرْقِيًّا ①



18. Ajo vuri perde mes vetes dhe atyre, atëherë Ne i dërguam engjëjllin Tonë dhe ai iu shëmbëllye me një njeri të përsosur.

فَاتَّخَذَتْ مِنْ دُونِهِمْ حِجَابًا فَأَرْسَلْنَا إِلَيْهَا رُوحَنَا فَتَمَثَّلَ لَهَا بَشَرًا سَوِيًّا ۝١٨

19. Ajo tha: “Njëmend, kërkoj mbrojtjen e të Gjithëmëshirshmit prej teje, nëse ke druajtje (ndaj Tij).”

قَالَتْ إِنِّي أَعُوذُ بِالرَّحْمَنِ مِنْكَ إِنْ كُنْتَ تَقِيًّا ۝١٩

20. Ai tha: “Jam i dërguari i Zotit tënd, që të të dhuroj një djalë të dëlirë.”

قَالَ إِنَّمَا أَنَا رَسُولُ رَبِّكِ لِأَهَبَ لَكِ غُلَامًا زَكِيًّا ۝٢٠

21. Ajo tha: “Si mund të kem unë djalë kur nuk më ka prekur njeri dhe as nuk jam e pandershme?!”

قَالَتْ أَنَّى يَكُونُ لِي غُلَامٌ وَلَمْ يَمَسِّنِي بَشَرٌ وَلَمْ أَكُ بَغِيًّا ۝٢١

22. “Kështu është”, tha ai. Zoti yt tha: “Kjo është e lehtë për Mua dhe (Ne do ta krijojmë),<sup>2</sup> që ta bëjmë atë shenjë për njerëzit dhe mëshirë prej Nesh. Kjo është një çështje e kryer.”

قَالَ كَذَلِكَ قَالَ رَبُّكِ هُوَ عَلَيَّ هَيِّئًا وَلِنَجْعَلَ آيَةً لِلنَّاسِ وَرَحْمَةً مِنَّا وَكَانَ أَمْرًا مَقْضِيًّا ۝٢٢

23. Ajo e mbarti atë dhe u tërhoq me të në një vend të largët.

فَحَمَلَتْهُ فَانْتَبَدَتْ بِهِ مَكَانًا قَصِيًّا ۝٢٣

24. Dhimbjet e lindjes e çuan drejt një trungu hurme. Tha: “Mjerë unë! Sikur të kisha vdekur përpara kësaj dhe të isha tërësisht e harruar!”

فَأَجَاءَهَا الْمَخَاضُ إِلَى جِذْعِ النَّخْلَةِ قَالَتْ يَلَيْتَنِي مِتُّ قَبْلَ هَذَا وَكُنْتُ نَسِيًّا مَنْسِيًّا ۝٢٤

25. Atëherë e thirri (një thirrës) nga poshtë: “Mos u brengos! Zoti yt ka bërë të rrjedhë një burim poshtë teje.

فَنَادَاهَا مِنْ تَحْتِهَا أَلَّا تَحْزَنِي قَدْ جَعَلَ رَبُّكِ تَحْتَكِ سَرِيًّا ۝٢٥

26. Dhe shkunde trungun e hurmës drejt vetes, do të të lëshojë hurma të freskëta.

وَهَرِيءَ إِلَيْكَ بِجِذْعِ النَّخْلَةِ تُسْقِطُ عَلَيْكَ رَطْبًا جَنِيًّا ۝٢٦

2. Fjalët që janë në kllapa, sipas imam Kurtubiut, janë të nënkuptuara në këtë ajet. (Tefsir El-Kurtubi)

27. Ha, pi dhe qetëso sytë. Nëse shikon ndonjë njeri, thuaji: Kam agjëruar për hir të të Gjithëmëshirshmit, andaj, nuk do t'i flas njeriu sot.”

28. Më pas, ajo erdhi me të te populli i saj, duke e mbartur atë. Ata thanë: “O Merjeme! Paskë bërë një gjë të turpshme!

29. Oj motra e Harunit!<sup>3</sup> Babai yt nuk ishte njeri i keq e as nëna jote nuk ishte e pandershme!”

30. Ajo drejtoi tek ai. Ata thanë: “Si mund të flasim me atë që është fëmijë në djep?!”

31. (Isai) tha: “Unë jam rob i Allahut; Ai më dha Librin dhe më bëri profet;

32. më bëri të bekuar kudo që të jem dhe më porositi për namazin dhe zekatin gjersa të jem i gjallë;

33. (më bëri) të sjellshëm ndaj nënës sime dhe nuk më bëri të rreptë (ose) të pabindur.

34. Dhe paqja është mbi mua ditën kur kam lindur, ditën kur do të vdes dhe ditën kur do të ringjallem”.

فَكُلِّيْ وَاشْرِبِيْ وَكَرِيْ عَيْنًاۙ فَاِمَّا تَرِيْنَ  
مِنَ الْبَشْرِ اَحَدًاۙ فَقُوِيْۙ اِنِّيْ نَذَرْتُ  
لِلرَّحْمٰنِ صَوْمًاۙ فَلَنْ اُكَلِّمَ الْيَوْمَ اِنْسِيًّاۙ ﴿٢٧﴾

فَاَتَتْ بِهٖ قَوْمَهَا تَحْمِلُهٗۙ قَالُوْۤا يٰرَيْمُ لَقَدْ  
جِئْتِ سَيِّئًاۙ قَرِيًّاۙ ﴿٢٨﴾

يَاۤاَحْتِ هُرُوْنَۙ مَا كَانَ اَبُوْكَ اِمْرًا سَوِيًّاۙ  
وَمَا كَانَتْ اُمُّكَ بَغِيًّاۙ ﴿٢٩﴾

فَاَشَارَتْ اِلَيْهٖۙ قَالُوْۤا كَيْفَ نُكَلِّمُ مَنْ كَانَ  
فِي الْمَهْدِ صَبِيًّاۙ ﴿٣٠﴾

قَالَ اِنِّيْ عَبْدُ اللّٰهِۙ اُنۡسِيَ الْكِتٰبَ وَجَعَلَنِيْ  
نَبِيًّاۙ ﴿٣١﴾

وَجَعَلَنِيْ مُبْرَكًاۙ اَيْنَ مَا كُنْتُۙ وَاَوْصٰنِيْ  
بِالصَّلٰوةِ وَالزَّكٰوةِۙ مَا دُمْتُ حَيًّاۙ ﴿٣٢﴾

وَبَرًّاۙ اِبْوَالِدٰتِيْۙ وَاَلَمْ يَجْعَلْنِيْ جَبْرًاۙ شَقِيًّاۙ ﴿٣٣﴾

وَالسَّلٰمُ عَلٰى يَوْمِ وُلِدْتُۙ وَيَوْمِ اَمُوْتُ  
وَيَوْمِ اُبْعَثُۙ حَيًّاۙ ﴿٣٤﴾

3. *Hazret* Merjemes hebrejtë i drejtohen me fjalët *motra e Harunit*. Po kjo sure, në pjesën e fundit të saj, tregon se nuk bëhet fjalë për Profetin Harun<sup>as</sup>, sepse për të aty thuhet qartazi se ai ishte vëllai i Musait<sup>as</sup>, kurse Merjemja<sup>as</sup> erdhi shekuj pas tij. Kështu që, populli i saj ose iu drejtua me ironi, ose Merjemja ka pasur ndonjë vëlla të vetin me emrin Harun.

35. Ky është Isai biri i Merjemes. (Dhe kjo është) fjala e vërtetë në të cilën ata dyshojnë.

36. Nuk i shkon Allahut të marrë bir. I Shenjtë është Ai! Kur vendos një çështje, Ai për të vetëm thotë: “Bëhu!”, dhe ajo bëhet.

37. Sigurisht, Allahu është Zoti im dhe Zoti juaj, prandaj, Atë adhurojeni. Kjo është rrugë e drejtë.

38. Por, grupet brenda tyre kundërshtuan. Shkatërrim për mohuesit nëpërmjet paraqitjes (së tyre) në një ditë të rëndë!

39. Sa mirë do të dëgjojnë ata dhe sa mirë do të shohin ditën kur do të vijnë te Ne! Ndonëse sot keqbërësit janë në humbje të qartë!

40. Alarmoji ata nga dita e dëshpërimit, kur të jetë dhënë vendimi, ndonëse ata janë në shkujdesje dhe nuk besojnë.

41. Pa dyshim, Ne e trashëgojmë tokën dhe këdo që është mbi të, dhe te Ne ata do të kthehen.

42. Dhe përmende në (këtë) Libër Ibrahimin. Përnjëmend, ai ishte i vërtetë (dhe) profet.

43. Kur ai i tha babait të tij: “O babai im! Pse adhuron diçka që as nuk dëgjon, as nuk shikon dhe as nuk të kryen ndonjë punë?”

ذٰلِكَ عِيسَى ابْنُ مَرْيَمَ ۚ قَوْلَ الْحَقِّ الَّذِي فِيهِ يَمْتَرُونَ ﴿٣٥﴾

مَا كَانَ لِلّٰهِ اَنْ يَّتَّخِذَ مِنْ وَّلَدٍ لَّسَبْحٰهُ ۗ اِذْ اَقْسَىٰ اَمْرًا فَاَلْتَمَا يَقُوْلُ لَهٗ كُنْ فَيَكُوْنُ ۗ ﴿٣٦﴾

وَ اِنَّ اللّٰهَ رَبِّيْ وَرَبُّكُمْ فَاعْبُدُوْهُ ۗ هٰذَا صِرَاطٌ مُّسْتَقِيْمٌ ﴿٣٧﴾

فَاخْتَلَفَ الْاَحْزَابُ مِنْ بَيْنِهِمْ ۗ فَوَيْلٌ لِّلَّذِيْنَ كَفَرُوْا مِنْ مَّشْهَدِ يَوْمٍ عَظِيْمٍ ﴿٣٨﴾

اَسْمِعْ بِهِمْ وَاَبْصُرْ ۗ يَوْمَ يَأْتُوْنَا لٰكِنَ الظّٰلِمُوْنَ الْاَيُّوْمَ فِيْ ضَلٰلٍ مُّبِيْنٍ ﴿٣٩﴾

وَاَنْذِرْهُمْ يَوْمَ الْحَسْرَةِ اِذْ قُضِيَ الْاَمْرُ ۗ وَهُمْ فِيْ غَفْلَةٍ وَهُمْ لَا يُؤْمِنُوْنَ ﴿٤٠﴾

اِنَّا نَحْنُ نَرِثُ الْاَرْضَ وَمَنْ عَلَيْهَا وَاِلَيْنَا يَرْجِعُوْنَ ﴿٤١﴾

وَ اذْكُرْ فِي الْكِتٰبِ اِبْرٰهِيْمَ ۗ اِنّٰهُ كَانَ صِدِّيْقًا نَّبِيًّا ﴿٤٢﴾

اِذْ قَالَ لِاَبِيْهِ يَا اَبَتَ لِمَ تَعْبُدُ مَا لَا يَسْمَعُ وَلَا يُبْصِرُ وَلَا يُعْنِيْ عَنْكَ شَيْءٌ ﴿٤٣﴾

44. O babai im! Me të vërtetë mua më ka ardhur dija që ty nuk të ka ardhur, prandaj më ndiq mua, unë do të të prij në rrugë të saktë.

يَا بَتِ إِنِّي قَدْ جَاءَنِي مِنَ الْعُلْمِ مَا لَمْ يَأْتِكَ فَاتَّبِعْنِي أَهْدِكَ صِرَاطًا سَوِيًّا ۝٤٤

45. O babai im! Mos adhuro djallin! Njëmend, djalli është mosbindës ndaj të Gjithëmëshirshmit.

يَا بَتِ لَا تَعْبُدِ الشَّيْطَانَ ۖ إِنَّ الشَّيْطَانَ كَانَ لِلرَّحْمَنِ عَصِيًّا ۝٤٥

46. O babai im! Kam frikë që do të të prekë ndonjë ndëshkim prej të Gjithëmëshirshmit dhe ti (atëherë) do të dalësh shok i djallit.”

يَا بَتِ إِنِّي أَخَافُ أَنْ يَمَسَّكَ عَذَابٌ مِّنَ الرَّحْمَنِ فَتَكُونَ لِلشَّيْطَانِ وَلِيًّا ۝٤٦

47. Ai tha: “Po ti, a u shmangesh zotave të mi, o Ibrahim?! Po nuk hoqe dorë, unë përnjëmend do të të gurëzoj! Largohu prej meje për një kohë të gjatë!”

قَالَ أَرَأِغِبُ أَنْتَ عَنِ الْهَيْتِ يَا بَرَاهِيمُ ۚ لَئِنْ لَّمْ تَنْتَهَ لِأَرْجَمَتَكَ وَاهْجَرْتَنِي مَلِيًّا ۝٤٧

48. (Ibrahimi) tha: “Paqe qoftë mbi ty! Unë do t’i kërkoj falje Zotit tim për ty. Ai është Bamirës ndaj meje.

قَالَ سَلِمَ عَلَيْكَ ۚ سَأَسْتَغْفِرُكَ رَبِّي ۖ إِنَّهُ كَانَ بِي حَفِيًّا ۝٤٨

49. Unë do t’ju largohem juve dhe atyre që adhuronin në vend të Allahut dhe do t’i lutem Zotit tim. Mundet të mos dalë i pafat me lutjen time ndaj Zotit tim.”

وَأَعْتَرْتُكُمْ وَمَا تَدْعُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ وَأَدْعُوا رَبِّي عَسَىٰ أَلَا أَكُونَ بِدُعَاءِ رَبِّي شَقِيًّا ۝٤٩

50. Dhe kur ai iu largua këtyre dhe atyre që ata adhuronin në vend të Allahut, Ne i dhuruam Is’hakun dhe Jakubin, dhe të gjithë këta i bëmë profetë.

فَلَمَّا اعْتَرَضَهُمْ وَمَا يَعْبُدُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ ۗ وَهَبْنَا لَهُ إِسْحَاقَ وَيَعْقُوبَ ۖ وَكُلًّا جَعَلْنَا نَبِيًّا ۝٥٠

51. Këtyre u dhuruam mëshirën Tonë dhe lamë për ta një famë të vërtetë, të lartë.

وَوَهَبْنَا لَهُمْ مِنْ رَحْمَتِنَا وَجَعَلْنَا لَهُمْ لِسَانَ صِدْقٍ عَلِيًّا ۝٥١

52. Dhe përmende në (këtë) Libër Musain. Pa dyshim, ai ishte i përzgjedhur dhe ishte i Dërguar (dhe) Profet.

وَأَذْكُرُ فِي الْكِتَابِ مُوسَىٰ إِنَّهُ كَانَ مُخْلَصًا  
وَكَانَ رَسُولًا نَّبِيًّا ﴿٥٧﴾

53. Ne e thirrëm nga ana e djathtë e Turit dhe e afruam me pëshpëritje.

وَنَادَيْنَاهُ مِنْ جَانِبِ الطُّورِ الْأَيْمَنِ وَقَرَّبْنَاهُ  
نَجِيًّا ﴿٥٨﴾

54. Atij i dhuruam përmes mëshirës Sonë vëllanë e tij, Harunin si profet.

وَ هَبْنَا لَهُ مِنْ رَحْمَتِنَا أَخَاهُ هَارُونَ نَبِيًّا ﴿٥٩﴾

55. Përmende në (këtë) Libër edhe Ismailin. Pa dyshim, ai mbante premtimin dhe ishte i Dërguar (dhe) Profet.

وَأَذْكُرُ فِي الْكِتَابِ إِسْمَاعِيلَ إِنَّهُ كَانَ صَادِقَ  
الْوَعْدِ وَكَانَ رَسُولًا نَبِيًّا ﴿٦٠﴾

56. Ai porosiste njerëzit e shtëpisë së tij për namazin dhe zekatin dhe ishte shumë i dashur pranë Zotit të tij.

وَكَانَ يَأْمُرُ أَهْلَهُ بِالصَّلَاةِ وَالزَّكَاةِ وَكَانَ  
عِنْدَ رَبِّهِ مَرْضِيًّا ﴿٦١﴾

57. Përmende në (këtë) Libër edhe Idrisin. Ai ishte Profet (dhe) i vërtetë.

وَ أَذْكُرُ فِي الْكِتَابِ إِدْرِيْسَ إِنَّهُ كَانَ  
صِدِّيقًا نَبِيًّا ﴿٦٢﴾

58. Ne e ngritëm atë në një vend të lartë.

وَرَفَعْنَاهُ مَكَانًا عَلِيًّا ﴿٦٣﴾

59. Pikërisht këta ishin që Allahu i bekoj, që ishin Profetë prej pasardhësve të Ademit dhe prej atyre që mbartëm bashkë me Nuhun dhe prej pasardhësve të Ibrahimit, të Izraelit dhe prej atyre që Ne i udhëzuam dhe i zgjodhëm. Kur atyre u lexoheshin ajetet e të Gjithëmëshirshmit, ata binin duke bërë sexhde dhe duke qarë.

أُولَٰئِكَ الَّذِينَ أَنْعَمَ اللَّهُ عَلَيْهِمْ مِنَ النَّبِيِّينَ  
مَنْ ذُرِّيَّةُ آدَمَ وَمِمَّنْ حَمَلْنَا مَعَ نُوحٍ  
وَمِنْ ذُرِّيَّةِ إِبْرَاهِيمَ وَإِسْرَائِيلَ وَمِمَّنْ  
هَدَيْنَا وَاجْتَبَيْنَا إِذَا تُتْلَىٰ عَلَيْهِمْ آيَاتُ  
الرَّحْمَنِ خَرُّوا سُجَّدًا وَبُكِيًّا ﴿٦٤﴾

60. Pastaj, ata u zëvendësuan nga brezni (të tjera) që prishën namazin dhe ndoqën dëshirat e veta. Ata patjetër do ta gjejnë pasojën e devijimit (të tyre),

فَخَلَفَ مِنْ بَدِهِمْ خَلْفٌ أَضَاعُوا  
الصَّلَاةَ وَاتَّبَعُوا الشَّهْوَاتِ فَسَوْفَ يَلْقَوْنَ  
عَذَابًا ۝

61. përveç atyre që u penduan, besuan dhe bënë të mira. Pikërisht këta do të hyjnë në xhenet dhe atyre nuk do t'u bëhet padrejtësi aspak.

إِلَّا مَنْ تَابَ وَآمَنَ وَعَمِلَ صَالِحًا فَأُولَٰئِكَ  
يَدْخُلُونَ الْجَنَّةَ وَلَا يُظْلَمُونَ شَيْئًا ۝

62. (Do të jenë) në xhenetet e përhershme, që u premtoi i Gjithëmëshirshmi robërve të Tij përmes së padukshmes. Sigurisht, premtimi i Tij përmbushet.

جَنَّاتٍ عَدْنٍ الَّتِي وَعَدَ الرَّحْمَنُ عِبَادَهُ  
بِالْغَيْبِ ۗ إِنَّهُ كَانَ وَعْدُهُ مَأْتِيًا ۝

63. Ata nuk do të dëgjojnë në to asnjë kotësi, por vetëm paqe dhe në to do të kenë ushqimin e tyre në mëngjes e në mbrëmje.

لَا يَسْمَعُونَ فِيهَا لُعْنًا إِلَّا سَلَامًا ۗ وَلَهُمْ  
رِزْقُهُمْ فِيهَا بُكْرَةً وَعَشِيًّا ۝

64. Ky është xheneti, të cilin do t'ia trashëgojmë kujtdo prej robërve Tanë që ka drujtje (ndaj Nesh).

تِلْكَ الْجَنَّةُ الَّتِي نُورِثُ مِنْ عِبَادِنَا  
مَنْ كَانَ تَقِيًّا ۝

65. (Engjëjt thonë:) Ne nuk zbresim përveçse me urdhrin e Zotit tënd; e Atij është ajo që është para nesh, ajo që është pas nesh dhe ajo që është mes kësaj; dhe Zoti yt nuk harron.

وَمَا نَنْزِلُ إِلَّا بِأَمْرِ رَبِّكَ ۗ لَهُ مَا بَيْنَ  
أَيْدِينَا وَمَا خَلْفَنَا وَمَا بَيْنَ ذَلِكَ ۗ وَمَا كَانَ  
رَبُّكَ نَسِيًّا ۝

66. Ai është Zoti i qiejve dhe i tokës dhe i asaj që është mes të dyjave. Prandaj, Atë adhuroje dhe qëndro i duruar në adhurimin e Tij. A di ndonjë emnak të Tij?!

رَبِّ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا فَاعْبُدْهُ  
ۙ وَاصْطَبِرْ لِعِبَادَتِهِ ۗ هَلْ تَعْلَمُ لَهُ سَمِيًّا ۝

67. Thotë njeriu: “Kur do të vdes, a do të nxirrem sërish i gjallë?!”

وَيَقُولُ الْإِنْسَانُ ۖ إِذَا مَا مِيتٌ لَسَوْفَ  
أُخْرَجُ حَيًّا ۝

68. A nuk e kujton njeriu që Ne e krijuam atë edhe më parë, kur ai ishte asgjë?!

أَوَلَا يَذْكُرُ الْإِنْسَانُ أَنَّا خَلَقْنَاهُ مِنْ قَبْلُ  
وَلَمْ يَكُ شَيْئًا ۝١٨

69. Për Zotin tënd! Ne patjetër do t'i grumbullojmë ata dhe djajtë, dhe do t'i sjellim të gjunjëzuar rreth xhehenemit.

فَوَرَبِّكَ لَنَحْضُرَنَّهُمُ وَالشَّيْطِينَ ثُمَّ  
لَنَحْضُرَنَّهُمْ حَوْلَ جَهَنَّمَ جِثِيًّا ۝١٩

70. Më pas nga çdo grup do të nxjerrim atë që ishte më i forti prej tyre në mosbindje.

ثُمَّ لَنَنْزِعَنَّ مِنْ كُلِّ شِيعَةٍ أَيُّهُمْ أَشَدُّ  
عَلَى الرَّحْمَنِ عِتِيًّا ۝٢٠

71. Dhe jemi Ne që dimë më së miri se cilët prej tyre meritojnë më shumë të digjen në të.

ثُمَّ لَنَحْنُ أَعْلَمُ بِالَّذِينَ هُمْ أَوْلَىٰ بِهَا  
صِلِيًّا ۝٢١

72. Çdokush nga ju (o keqbërës), do të bjerë në të. Zoti yt këtë e ka marrë përsipër si vendim të prerë.<sup>4</sup>

وَأِنْ مِنْكُمْ إِلَّا وَارِدُهَا كَانَ عَلَىٰ رَبِّكَ  
حَتْمًا مَقْضِيًّا ۝٢٢

73. Pastaj do të shpëtojmë ata që patën druajtje, kurse keqbërësit do t'i lëmë të gjunjëzuar në të.

ثُمَّ نُنَجِّي الَّذِينَ اتَّقَوْا وَ نَذَرُ الظَّالِمِينَ  
فِيهَا جِثِيًّا ۝٢٣

74. Dhe kur atyre u lexohen ajetet Tona të qarta, ata që mohuan u thonë atyre që besuan: “Cili prej dy grupeve (prej jush) është më i miri në pozitë dhe më i miri për shoqëri?”

وَإِذَا تُلِيٰ عَلَيْهِمُ آيَاتُنَا بِبَيِّنَاتٍ قَالَ الَّذِينَ  
كَفَرُوا لِلَّذِينَ آمَنُوا أَيُّ الْفَرِيقَيْنِ خَيْرٌ  
مَّقَامًا وَأَحْسَنُ نَدِيًّا ۝٢٤

75. Dhe sa shumë brezni para tyre kemi shkatërruar, të cilat ishin më të mira (se këta) në pajime dhe në dukje!

وَكَمْ أَهْلَكْنَا قَبْلَهُمْ مِنْ قَرْنٍ هُمْ أَحْسَنُ  
أَنفُسًا وَرِءْيَاءَ ۝٢٥

4. Fjalët “çdokush nga ju do të bjerë në të” nuk do të thotë se çdo njeri do të bjerë në të, sepse për njerëzit e dëlirë, Kurani i Shenjtë thotë se ata nuk do të dëgjojnë as zhurmën më të lehtë të xhehenemit (21:103). Ose xhehenemi që përmendet në këtë ajet, nëse është për të gjithë, i referohet xhehenemit të botës, të cilin njerëzit e dëlirë e durojnë për hir të Zotit. Po kështu, edhe keqbërësit shpesh heqin lloj-lloj vuajtjesh që në këtë botë, të cilat janë një lloj xhehenemi që ata e pësojnë.

76. Thuaj: Ata që janë të devijuar, i Gjithëmëshirshmi u lëshon pak kohë, më në fund, kur ata e shohin atë që u është premtuar, pra ndëshkimin, ose Orën e Kiametit, patjetër do të mësojnë se cili është më i keqi në pozitë dhe më i dobëti në përforsime.

قُلْ مَنْ كَانَ فِي الصَّلَاةِ فليمدد له الرحمنُ  
مددًا حتى إذا رآوا ما يوعدون إنا  
العذابَ وإنا الساعةُ<sup>ط</sup> فسيعلمون من هو  
شرُّ مكانًا وأضعفُ جندًا ﴿٧٦﴾

77. Dhe ata që u udhëzuan, Allahu do t'ua shtojë udhëzimin. Mirësitë që qëndrojnë janë më të mira pranë Zotit tënd në shpërblim dhe më të mira në përfundim.

ويزيد الله الذين اهتدوا هدى<sup>ط</sup> والبقية  
الصلوات خير عند ربك ثوابًا وخير  
مرادًا ﴿٧٧﴾

78. A e ke parë atë që mohoi shenjat Tona dhe tha: “Unë patjetër do të gëzoj pasuri dhe fëmijë!”?

أفرأيت الذي كفر بآيتنا وقال لأوتين  
مالًا وولدًا ﴿٧٨﴾

79. A u njoftua ai për të padukshmen apo ka marrë ndonjë premtim pranë të Gjithëmëshirshmit?!

أطلع العيب أم اتخذ عند الرحمن عهدًا ﴿٧٩﴾

80. Përkundrazi! Ne përnjëmend do ta shënojmë atë që thotë ai dhe do t'ia shtojmë ndëshkimin!

كلاً سنكتب ما يقول ونمدله من  
العذابِ مددًا ﴿٨٠﴾

81. Dhe Ne e trashëgojmë atë që thotë ai, kurse ai te Ne do të vijë i vetëm.

ونرثه ما يقول ويأيننا فردًا ﴿٨١﴾

82. Ata morën të adhurueshëm të tjerë në vend të Allahut, që ata t'u bëhen shenjë nderi.

واتخذوا من دون الله إلهة ليكفونوا  
لهم عذابًا ﴿٨٢﴾

83. Përkundrazi! Ata patjetër do ta mohojnë adhurimin e tyre dhe do t'u dalin kundër.

كلاً سيكفرون بعبادتهم ويكفونون  
عليهم ضدادًا ﴿٨٣﴾

84. A nuk e ke parë që Ne dërgojmë kundër mohuesve djajtë që i nxisin në shumë forma?!

ألم تر آتانا أرسلنا الشياطين على الكافرين  
تؤرهم آراءًا ﴿٨٤﴾



85. Prandaj, mos u nxito rreth tyre.  
Ne po ua numërojmë çdo çast.

فَلَا تَعْجَلْ عَلَيْهِمْ ۗ إِنَّمَا نَعُدُّ لَهُمْ عَدًّا ۗ ﴿٨٥﴾

86. Ditën kur do të mbledhim  
të druajturit pranë të Gjithë-  
mëshirshmit në formë grupi (të  
nderuar).

يَوْمَ نَحْشُرُ الْمُتَّقِينَ إِلَى الرَّحْمَنِ وَفْدًا ۗ ﴿٨٦﴾

87. Kurse fajtorët do t'i shtyjme të  
përfundojnë drejt xhehenemit.

وَأَسْوَقُ الْمَجْرِمِينَ إِلَىٰ جَهَنَّمَ وَرِدًّا ۗ ﴿٨٧﴾

88. Ata nuk do të kenë fuqi për asnjë  
ndërmjetësim, me përjashtim të atij  
që ka marrë një premtim pranë të  
Gjithëmëshirshmit.

لَا يَمْلِكُونَ الشَّفَاعَةَ إِلَّا مَنِ اتَّخَذَ عِنْدَ  
الرَّحْمَنِ عَهْدًا ۗ ﴿٨٨﴾

89. Dhe ata thanë: “I Gjithë-  
mëshirshmi ka marrë bir”!

وَقَالُوا اتَّخَذَ الرَّحْمَنُ وَلَدًا ۗ ﴿٨٩﴾

90. “Ju përnjëmend keni sajuar një  
gjë të gjëmshme!”

لَقَدْ جِئْتُمْ شَيْئًا إِدًّا ۗ ﴿٩٠﴾

91. Qiejt janë gati të pëlcastin nga ajo,  
toka të çahet dhe malet të shemben  
duke u dridhur!

تَكَادُ السَّمَوَاتُ يَتَّقَطِرْنَ مِنْهُ وَتَنْشَقُّ الْأَرْضُ  
وَتَخِرُّ الْجِبَالُ هَدًّا ۗ ﴿٩١﴾

92. Që ata pretenduan bir për të  
Gjithëmëshirshmin!

أَنْ دَعَوْا لِلرَّحْمَنِ وَلَدًا ۗ ﴿٩٢﴾

93. Nuk i shkon të Gjithë-  
mëshirshmit të marrë bir.

وَمَا يَنْبَغِي لِلرَّحْمَنِ أَنْ يَتَّخِذَ وَلَدًا ۗ ﴿٩٣﴾

94. Njëmend, kushdo që është  
në qiej dhe tokë, do t'i vijë të  
Gjithëmëshirshmit vetëm si rob.

إِنْ كُلُّ مَنْ فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ إِلَّا آتِي  
الرَّحْمَنِ عَبْدًا ۗ ﴿٩٤﴾

95. Pa dyshim, Ai u ka vënë rreth  
atyre dhe i ka numëruar një për një.

لَقَدْ أَحْصَاهُمْ وَعَدَّهُمْ عَدًّا ۗ ﴿٩٥﴾

96. Secili prej tyre do t'i vijë vetëm,  
Ditën e Kiametit.

وَكُلُّهُمْ آتِيهِ يَوْمَ الْقِيَامَةِ فَرْدًا ۗ ﴿٩٦﴾

97. Sigurisht, për ata që besuan dhe bënë të mira, i Gjithëmëshirshmi do të krijojë dashuri për ta.

إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ سَيَجْعَلُ  
لَهُمُ الرَّحْمَنُ وُدًّا ﴿٩٧﴾

98. Dhe sigurisht, Ne e kemi bërë këtë (Kuran) të rrjedhshëm në gjuhën tënde, që përmes këtij t'u japësh lajmin e mirë të druajturve (ndaj Nesh) dhe po përmes këtij të alarmosh popullin grindavec.

فَإِنَّمَا يَسَّرْنَاهُ بِلِسَانِكَ لِتُبَشِّرَ بِهِ الْمُتَّقِينَ  
وَتُنذِرَ بِهِ قَوْمًا لُدًّا ﴿٩٨﴾

99. Dhe sa shumë brezni kemi shkatërruar përpara tyre! A mund të ndiesh qoftë ndonjërën prej tyre ose t'u dëgjosh ndonjë pëshpërimë?!

وَكَمْ أَهْلَكْنَا قَبْلَهُمْ مِنْ قَرْنٍ هَلْ  
تُحِشُّ مِنْهُمْ مِنْ أَحَدٍ أَوْ تَسْمَعُ لَهُمْ  
النَّصِيحَةَ رِكْرًا ﴿٩٩﴾

## Surja 20 – Ta.Ha

Surja Ta.Ha. është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka njëqind e tridhjetë e gjashtë ajete.

Kjo sure fillon me shkurtesat Ta.Ha., të cilat nuk përsëriten në ndonjë sure tjetër. Kuptimi i tyre është: O i Dërguar i Pastër (*Tajjib*) dhe Udhëzues i Përsosur (*Hadi*)!

Paralajmërimi për luftëra të përgjakshme që dha surja paraardhëse, pa dyshim, duhet ta kishte brengosur Profetin Muhammed<sup>savs</sup>, prandaj, Zoti i Madhërishëm në këtë sure e porositi bindshëm të mos brengosej. Kjo *zbritje* është prej Atij që krijoi tokën dhe qiejt, prej të Gjithëmëshirshmit që u vendos mbi Arsh.

Profetët vijnë për shkak se Zoti është *i Gjithëmëshirshëm (Rrahman)* dhe ngjashëm me suren e kaluar, edhe kjo sure mbart temën e të Gjithëmëshirshmit. Prandaj, edhe një herë përmendet se si i Gjithëmëshirshmi caktoi *Hazret Musain<sup>as</sup>* të Dërguarin e Vet dhe se të gjitha bekimet që Ai i dha atij, e kanë burimin pikërisht tek atributi *i Gjithëmëshirshëm*.

Po kjo sure përmend sexhden e magjistarëve dhe kërcënimin e llahtarshëm që u bëri Faraoni. Por, ata që njëherë dëshmojnë shfaqjen e të Gjithëmëshirshmit, nuk frikësohen aspak nga kërcënimet e tilla. Prandaj, edhe magjistarët nuk u lëkundën aspak në besimin ndaj *Hazret Musait<sup>as</sup>*, pavarësisht nga çdolloj kërcënimi që u bëri Faraoni.

Më pas, duke iu drejtuar Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, Zoti i Madhërishëm thotë: “Ata të pyesin rreth maleve”. Profeti<sup>savs</sup> nuk u pyet asnjëherë nga idhujtarët për malet. Po ata e pyesnin se si do t’ia dilte ai me superfuqitë e kohës – me mbretërinë e Kirasës dhe me atë të Kajserit, të cilat simbolizonin male të fuqishme. Superfuqitë e botës që kanë kokën lart sikur malet, nuk besojnë derisa nuk do t’u shembet egoja dhe derisa nuk do të shndërrohen në shkretëtirë rëre të tillë, që nuk ka as ultësi e as lartësi. Kur do të ndodhë kjo, atëherë ata do t’i binden një të dërguari, që nuk ka asnjë shtrembësi në veten e tij.

Ajeti 109 përsërit të Gjithëmëshirshmin, po ashtu edhe ajeti 110, duke treguar madhështinë dhe ndikimin e këtij atributi që të gjithë zërat përpara Tij do të pushojnë dhe, edhe kur t’u duhet, mund të komunikojnë vetëm duke pëshpëritur.

Më pas sërish flitet për *Hazret Ademin<sup>as</sup>*, sepse edhe lindja e tij ishte një shfaqje e të Gjithëmëshirshmit. Këtu për herë të parë u përmendën katër parime themelore të Sheriatit të *Hazret Ademit<sup>as</sup>*. Kushdo që do ta pranonte *Hazret Ademin<sup>as</sup>*, do t’i jepej garanci që nuk do të mbetej as i uritur, as i zhveshur, as i etur dhe as i lënë në diell.

Pas kësaj, edhe njëherë tjetër Profetit Muhammed<sup>savs</sup> i jepet porosia që të duronte ndaj persekutimeve prej armikut dhe ta përkujtonte Zotin e tij, duke e lavdëruar Atë përpara se të lindë dielli, përpara se të perëndojë ai, në orët e natës dhe gjithashtu

edhe në të dyja skajet e ditës. Ky ajet flet për të gjitha namazet e ditës dhe të natës.

Në fund të kësaj sureje, Zoti i Madhërishëm e porositi Profetin<sup>savs</sup> të thoshte: Të gjithë po presin se cili do të jetë rezultati i kësaj ndeshjeje, andaj edhe ju prisni, sepse do t'ju bëhet shumë e qartë se cilët janë ndjekësit e rrugës së drejtë dhe cilët e gëzojnë udhëzimin.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Ta.Ha. (O i Dërguar i pastër dhe udhëzues!)

طه ②

3. Ne nuk të zbritëm Kuranin që të brengosesh.

مَا أَنْزَلْنَا عَلَيْكَ الْقُرْآنَ لِتَشْقَى ③

4. Por vetëm si këshillë për atë që frikësohet;

إِلَّا تَذِكْرَةً لِمَنْ يَخْشَى ④

5. si zbritje prej Atij që krijoi tokën dhe qiejt e lartë,

تَنْزِيلًا مِمَّنْ خَلَقَ الْأَرْضَ وَالسَّمَوَاتِ  
الْعُلَى ⑤

6. I Gjithëmëshirshmi (që) u vendos mbi Arsh.

الرَّحْمَنُ عَلَى الْعَرْشِ اسْتَوَى ⑥

7. E Atij është ajo që gjendet në qiejt dhe ajo që gjendet në tokë dhe ajo që gjendet mes të dyjave dhe ajo që gjendet nën dhe.

لَهُ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ وَمَا  
بَيْنَهُمَا وَمَا تَحْتَ الْعَرْشِ ⑦

8. Nëse flet me zë të lartë, (ta dish se) Ai me siguri di të fshehtën, dhe më të fshehtën.

وَإِنْ تَجَهَّرَ بِالنُّقُولِ فَإِنَّهُ يَعْلَمُ السِّرَّ  
وَآخْفَى ⑧

9. Allahu; nuk ka të adhurueshëm tjetër përveç Atij. Të Atij janë emrat më të bukur.

اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ ⑨ لَهُ الْأَسْمَاءُ الْحُسْنَى ⑩

10. A të erdhi historia e Musait?

وَهَلْ أَنْتَ حَدِيثُ مُوسَى ⑪

11. Kur ai pa zjarr dhe i tha familjes së tij: “Ndaluni! Kam parë një zjarr. Mund t’ju sjell ndonjë copëz prej tij

إِذْ رَأَى نَارًا فَقَالَ لِأَهْلِهِ امْكُثُوا إِنِّي  
أَنْتُمْ نَارًا أَلْعَلِّي آتِيكُمْ مِنْهَا بِقَبَسٍ أَوْ

ose të gjej udhëzim pranë zjarrit”.

إِجْدُ عَلَى النَّارِ هُدًى ⑩

12. Kur mbërriti tek ai, iu tha: “O Musa!

فَلَمَّا أَتَاهَا نُودِيَ يَمُوسَى ⑪

13. Unë jam Zoti yt. Hiqi këpucët. Ti je në luginën e shenjtë Tuva.<sup>1</sup>

إِنِّي أَنَا رَبُّكَ فَاحْلَعْ نَعْلَيْكَ ⑫ إِنَّكَ بِالْوَادِ  
الْمُقَدَّسِ طَوًى ⑬

14. Unë të kam zgjedhur, ndaj, dëgjo me vëmendje atë që shpallet.

وَأَنَا اخْتَرْتُكَ فَاسْتَمِعْ لِمَا يُوحَى ⑭

15. Pa dyshim, Unë jam Allahu, nuk ka të adhurueshëm tjetër përveç Meje, prandaj, Më adhuro Mua dhe fal namazin për të Më kujtuar Mua.

إِنِّي أَنَا اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنَا فَاعْبُدْنِي ⑮  
وَأَقِمِ الصَّلَاةَ لِذِكْرِي ⑯

16. Ora do të vijë patjetër. Unë mund ta mbaj të fshehur, që çdo shpirt të shpërblehet për atë që është përpjekur.

إِنَّ السَّاعَةَ آتِيَةٌ أَكَادُ أُخْفِيهَا لِتُجْرَمَ كُلُّ  
نَفْسٍ بِمَا تَسْعَى ⑰

17. Andaj, prej (përmbushjes së kërkesave të) saj kurrsesi të mos pengojë ty ai që nuk beson në të, që ndjek dëshirat e tij, se përndryshe do të shkatërrosh.

فَلَا يَصُدُّكَ عَنْهَا مَنْ لَّا يُؤْمِنُ بِهَا  
وَاتَّبَعَ هَوَاهُ فَتَرْدَى ⑱

18. Dhe çfarë ke në dorën tënde të djathtë, o Musa?”

وَمَا تِلْكَ بِيَمِينِكَ يَمُوسَى ⑲

19. (Musai) tha: “Ky është shkopi im. Mbështetem mbi të, shkund gjethet për dhentë e mia dhe kam edhe dobi të tjera prej tij.”

قَالَ هِيَ عَصَايَ ⑳ أَتَوَكَّأُ عَلَيْهَا وَأَهُشُّ  
بِهَا عَلَى غَنَمِي ㉑ وَلِي فِيهَا مَارِبٌ أُخْرَى ㉒

1. Ajetet 10 – 13: Për dritën që pa në formë zjarri, *Hazret Musai*<sup>as</sup> shprehu dy mundësi, dhe e dyta doli e vërtetë, pra “do të gjej udhëzim pranë zjarrit”. Pra, ai nuk ishte një zjarr, që *Hazret Musai*<sup>as</sup> të mund të shkëpuste ndonjë urë a shkëndijë të tij, për t’ua dhënë fizikisht edhe njerëzve të tjerë.

20. (Zoti) tha: “Hidhe, o Musa!”

قَالَ لَهَا يٰمُوسَىٰ ۝

21. Ai e hodhi dhe sakaq ai u bë një gjarpër që lëvizte!

فَأَلْفَهَا فَأَذَا هِيَ حَيَّةٌ تَسْعَىٰ ۝

22. Ai tha: “Kape dhe mos u frikëso. Ne do ta rikthejmë atë në gjendjen e tij të mëparshme.<sup>2</sup>”

قَالَ خُذْهَا وَلَا تَخَفْ ۖ سَنُعِيدُهَا سِيرَتَهَا الْأُولَىٰ ۝

23. Dhe tërhiqe dorën në anën tëndë. Ajo do të dalë e bardhë, pa ndonjë sëmundje,<sup>3</sup> (ja), një shenjë tjetër.

وَأَصْمُمُ يَدَكَ إِلَىٰ جَنَاحِكَ تَخْرُجُ بَيَّضَاءَ مِنْ غَيْرِ سَوْءٍ آيَةً أُخْرَىٰ ۝

24. Që të tregojmë ty disa nga shenjat Tona të mëdha.

لِنُرِيكَ مِنْ آيَاتِنَا الْكُبْرَىٰ ۝

25. Shko te Faraoni; ai njëmend u rebelua.”

۞ إِذْهَبْ إِلَىٰ فِرْعَوْنَ إِنَّهُ طَغَىٰ ۝

26. (Musai) tha: “O Zoti im! Më zgjero kraharorin!

قَالَ رَبِّ اشْرَحْ لِي صَدْرِي ۝

27. Më lehtëso punën!

وَيَسِّرْ لِي أَمْرِي ۝

28. Më zgjidh nyjën e gjuhës,

وَاحْلُلْ عُقْدَةً مِنْ لِسَانِي ۝

29. që ata të kuptojnë fjalën time!

يَفْقَهُوا قَوْلِي ۝

30. Cakto për mua një mëkëmbës nga familja ime,

وَأَجْعَلْ لِي وَزِيرًا مِنْ أَهْلِي ۝

31. Harunin, vëllanë tim.

هُرُونَ أَخِي ۝

2. Kjo shenjë prej Zotit përveç të tjerash i solli edhe mesazhin *Hazret Musait*<sup>as</sup> që popullin e tij ta mbante gjithmonë pranë. Ai e ka parë vetë që sa herë që shkëputej prej ndjekësve të tij, pa vonesë ata devijonin nga rruga e drejtë (20:86).

3. Libri i *Hazret Musait*<sup>as</sup> është Teurati, megjithatë ai nuk bën drejtësi me *Hazret Musain* kur tregon për bardhësinë e dorës së tij se “*dora ishte lebrosur*” (Bibla, Eksodi 4:6), por Kurani i Shenjtë pavarësisht se iu zbrit njërit nga bijtë e Ismailit (pra, jo-izrael), ia largon këtë damkë *Hazret Musait*<sup>as</sup> duke treguar se kjo bardhësi nuk kishte lidhje me asnjë sëmundje.

32. Më rrit forcën përmes tij.

أَشَدُّ بِهِ أَرْزَى ۞

33. Shtoje edhe atë në punën time.

وَأَشْرِكُهُ فِي أَمْرِي ۞

34. Që të Të lavdërojmë shumë,

كَيْ نُسَبِّحَكَ كَثِيرًا ۞

35. dhe të Të përkujtojmë shumë.

وَنَذُكُرَكَ كَثِيرًا ۞

36. Pa dyshim, Ti na je Gjithëshikues!”

إِنَّكَ كُنْتَ بِنَا بَصِيرًا ۞

37. (Zoti) tha: “Ty të është dhënë ajo që kërkove, o Musa!

قَالَ قَدْ أُوتِيتَ سُؤْلَكَ يَا مُوسَى ۞

38. Dhe Ne të patëm bërë mirësi edhe një herë tjetër.

وَلَقَدْ مَنَّا عَلَيْكَ مَرَّةً أُخْرَى ۞

39. Kur i shpallëm nënës sate atë që (duhej të) shpallej;

إِذْ أَوْحَيْنَا إِلَىٰ أُمِّكَ مَا يُوحَىٰ ۞

40. që: “Vëre (fëmijën) në sënduk, më pas vëre në lum. Lumi le ta çojë atë te bregu, atë do ta marrë një armiku Im dhe armiku i tij”. Unë kam futur në ty dashurinë Time dhe që ti të rriteshe para Syrit Tim.

أَنْ أَقْدِفِيهِ فِي التَّابُوتِ فَاقْدِفِيهِ فِي الْيَمِّ  
فَلْيُلْقِهِ الْيَمُّ بِالسَّاحِلِ يَأْخُذْهُ عَدُوِّي  
وَعَدُوْلَهُ ۗ وَالْقَيْتُ عَلَيْكَ مَحَبَّةٌ مِّمِّيَّ  
وَلْيَصْنَعِ عَلَىٰ عَيْنِي ۞

41. Kur motra jote po ecte dhe u thoshte: “A t’ju tregoj për dikë që do të kujdeset për të?” Kështu, të kthyem te nëna jote, që asaj t’i qetësoheshin sytë dhe të mos brengosej. Veç kësaj, ti vrave një njeri dhe Ne të shpëtuam nga brenga dhe të vumë në një sërë provash. Ti mbete mes njerëzve të Medjenit për disa vjet. Pastaj arrite në moshë të caktuar (për profetësinë), o Musa!

إِذْ تَمْشِي أَحْتَاكَ فَتَقُولُ هَلْ أَدُلُّكُمْ عَلَىٰ  
مَنْ يَكْفُلُهُ ۗ فَرَجَعْنَاكَ إِلَىٰ أُمِّكَ كَيْ تَقَرَّ  
عَيْنَهَا وَلَا تَحْزَنَ ۗ وَكُنْتَ نَفْسًا فَجْجِينِكَ  
مِنَ الْعَمْرِ وَقَدْنَاكَ فَمَوْنَا ۗ فَلَبِثْتَ سِنِينَ فِي  
أَهْلِ مَدْيَنَ ۗ ثُمَّ جِئْتَ عَلَىٰ قَدَرٍ يَا مُوسَىٰ ۞



42. Dhe të zgjedha për Vetën Time.

وَاصْطَنَعْتُكَ لِنَفْسِي ﴿٤٢﴾

43. Shko ti dhe vëllai yt me shenjat e Mia dhe mos u ngathtësoni në kujtimin Tim.

إِذْهَبْ أَنْتَ وَأَخُوكَ بِآيَاتِي وَلَا تَنِيَا فِي ذِكْرِي ﴿٤٣﴾

44. Shkoni te Faraoni sepse ai u rebelua.

إِذْهَبَا إِلَى فِرْعَوْنَ إِنَّهُ طَغَى ﴿٤٤﴾

45. Dhe flisni me të me fjalë të buta, ndoshta mendohet ose frikësohet.

فَقُولَا لَهُ قَوْلًا لَّيِّنًا لَعَلَّهُ يَتَذَكَّرُ أَوْ يَخْشَى ﴿٤٥﴾

46. Ata thanë: “O Zoti ynë! Kemi frikë se ai mos do të na shtypë ose të rebelohet.”

قَالَا رَبَّنَا إِنَّا نَخَافُ أَنْ يُفْرِطَ عَلَيْنَا أَوْ أَنْ يَطَّغَى ﴿٤٦﴾

47. Ai tha: “Mos u frikësoni, sigurisht, Unë jam me ju të dy; dëgjoj dhe shoh.”

قَالَ لَا تَخَافَا إِنِّي مَعَكُمْ أَسْمِعُ وَأَرَى ﴿٤٧﴾

48. Andaj, shkoni tek ai dhe thuajini: Njëmend, ne të dy jemi të dërguar të Zotit tënd, prandaj, dërgoju bijtë e Izraelit me ne dhe mos i dëno. Vërtet, ne të erdhëm me një shenjë prej Zotit tënd. Paqja qoftë mbi atë që ndjek udhëzimin!

فَأْتِيهِ فَقُولَا إِنَّا رَسُولَا رَبِّكَ فَأَرْسِلْ مَعَنَا بَنِي إِسْرَائِيلَ وَلَا تُعَذِّبْهُمْ قَدْ جِئْنَاكَ بِآيَةٍ مِّنْ رَبِّكَ وَالسَّلَامُ عَلَيَّ مَنِ اتَّبَعَ الْهُدَى ﴿٤٨﴾

49. Pa dyshim, neve na është shpallur që ndëshkimi do të jetë mbi atë që gënjen dhe e kthen shpinën.”

إِنَّا قَدْ أُوحِيَ إِلَيْنَا أَنَّ الْعَذَابَ عَلَى مَنْ كَذَّبَ وَتَوَلَّى ﴿٤٩﴾

50. (Faraoni) tha: “Kush është Zoti i ju të dyve, o Musa?”

قَالَ فَمَنْ رَبُّكُمَا يُمُوسَى ﴿٥٠﴾

51. Ai tha: “Zoti ynë është Ai që i dha çdo gjëje formën e saj e më pas e përudhi.”

قَالَ رَبُّنَا الَّذِي أَعْطَى كُلَّ شَيْءٍ حَلْقَهُ ثُمَّ هَدَى ﴿٥١﴾

52. (Faraoni) tha: “Atëherë, çfarë ndodh me popujt e mëparshëm?”

قَالَ فَمَا بَالُ الْقُرُونِ الْأُولَىٰ ﴿٥٢﴾

53. Ai tha: Dija e tyre është te Zoti im në një Libër. Zoti im as nuk devijon, as nuk harron;

قَالَ عَلِمَهَا عِنْدَ رَبِّي فِي كِتَابٍ لَا يَضِلُّ رَبِّي وَلَا يَنْسَىٰ ﴿٥٣﴾

54. Ai që krijoi për ju tokën si shtrat, për ju hapi rrugë në të, zbriti ujë prej qiellit dhe përmes tij nxori çifte të bimësive të shumëllojshme.

الَّذِي جَعَلَ لَكُمُ الْأَرْضَ مَهْدًا وَوَسَّلَكَ لَكُمُ فِيهَا سُبُلًا وَ أَنْزَلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً ۖ فَأَخْرَجْنَا بِهِ أَزْوَاجًا مِّن تَبَاتٍ شَتَّىٰ ﴿٥٤﴾

55. Hani dhe kullotni bagëtitë tuaja! Pa dyshim, në këtë ka shenja për të mençurit.

كُلُوا وَارْعَوْا أَنْعَامَكُمْ ۗ إِنَّ فِي ذَٰلِكَ لَآيَاتٍ لِّأُولِي النَّهْيِ ﴿٥٥﴾

56. Prej kësaj (toke) ju krijuam, në të do t'ju kthejmë dhe po prej saj do t'ju nxjerrim edhe një herë tjetër.<sup>4</sup>

مِنهَا خَلَقْنَاكُمْ وَفِيهَا نُعِيدُكُمْ وَمِنْهَا نُخْرِجُكُمْ تَارَةً أُخْرَىٰ ﴿٥٦﴾

57. Sigurisht, Ne ia treguam shenjat Tona që të gjitha, por ai i quajti gënjeshtra dhe i mohoi.

وَلَقَدْ آرَيْنَاهُ الْآيَاتِ كَلَّمَاهَا فَكَذَّبَ وَابَىٰ ﴿٥٧﴾

58. (Faraoni) tha: “A na ke ardhur për të na nxjerrë nga toka jonë me magjinë tënde, o Musa?!”

قَالَ اجْنُتْنَا لِنُخْرِجَنَّا مِنْ أَرْضِنَا بِسِحْرِكَ يَمُوسَىٰ ﴿٥٨﴾

59. Atëherë ne patjetër do të të sjellim një magji si kjo. Cakto ditë dhe vend mes nesh e teje, që as ne e as ti të mos mungojmë; (le të jetë) një vend i përbashkët (për ne të dy).”

فَلَنَأْتِيَنَّكَ بِسِحْرِ مِثْلِهِ فَأَجْعَلْ بَيْنَنَا وَبَيْنَكَ مَوْعِدًا لَا نُخْلِفُهُ نَحْنُ وَلَا أَنْتَ مَكَانًا سَوِيًّا ﴿٥٩﴾

4. Disa ngrenë pyetje ndaj këtij ajeti se si aplikohet ai mbi ata që vdesin në anijet kozmike ndërkohë që janë në hapësirë. Përgjigjja e saj është që njeriu kudo që të shkojë, është i detyruar të marrë me vete atmosferën dhe ushqimin e tokës dhe rrjedhimisht, gjendet brenda konturit të saj.

60. (Musai) tha: “Dita e caktuar për ju le të jetë dita e festës dhe njerëzit të grumbullohen paradite.”

قَالَ مَوْعِدُكُمْ يَوْمَ الزَّيْتَةِ وَأَنْ يُحْشَرَ  
النَّاسُ صُجًى ①

61. Faraoni u kthye, grumbulloi planin e tij dhe erdhi.

فَتَوَلَّى فِرْعَوْنُ فَجَمَعَ كَيْدَهُ ثُمَّ أَتَى ②

62. Musai u tha: “Vaj për ju! Mos shpifni mbi Allahun gënjeshtër, se Ai do t’ju shpartallojë me një ndëshkim. Njëmend, humb ai që trillon.”

قَالَ لَهُمْ مُوسَى وَيْلَكُمْ لَا تَفْتَرُوا عَلَيَّ  
اللَّهِ كَذِبًا فَيَسْحَبِكُمْ بِعَذَابٍ ③ وَقَدْ خَابَ  
مَنْ أَفْتَرَى ④

63. Ata vijuan të grindeshin me njëri-tjetrin në çështjen e tyre dhe pëshpëritnin fshehurazi.

فَتَنَازَعُوا أَمْرَهُمْ بَيْنَهُمْ وَأَسْرَأُوا النَّجْوَى ⑤

64. Thanë: “Pikërisht këta janë dy magjistarë që duan t’ju dëbojnë nga toka juaj përmes magjisë së tyre dhe ta asgjësojnë traditën tuaj shembullore!”

قَالُوا إِنْ هَذَا لَسِحْرَانِ يُرِيدَانِ أَنْ  
يُخْرِجَكُم مِّنْ أَرْضِكُمْ بِسِحْرِهِمَا  
وَيَذْهَبَا بِطَرِيقَتِكُمُ الْمُثَلَى ⑥

65. Prandaj, bashkoni planet tuaja dhe ejani të rreshtuar. Sot, do të fitojë ai që arrin të mbizotërojë.”

فَأَجْمِعُوا كَيْدَكُمْ ثُمَّ اتُّوَا صَفًّا ⑦  
أَفَلَا الْيَوْمَ مَنِ اسْتَعْلَى ⑧

66. Ata thanë: “O Musa! Ose ti hidh, ose ne të hedhim të parët.”

قَالُوا يُمُوسَى إِمَّا أَنْ تَتْلِيَنَا وَإِمَّا أَنْ نَكُونَ  
أَوَّلَ مَنْ أَلْفَى ⑨

67. (Musai) tha: “Jo! Hidhni ju.” Atëherë nga magjia e tyre papritmas iu duk që litarët dhe shkopinjët e tyre sikur po vraponin.

قَالَ بَلْ أَلْقُوا ⑩ فَإِذَا جِبَالُهُمْ وَعِصِيُّهُمْ  
يُخَيَّلُ إِلَيْهِ مِنْ سِحْرِهِمْ أَنَّهَا تَسْعَى ⑪

68. Musai ndjeu frikë brenda vetes.

فَأَوْجَسَ فِي نَفْسِهِ خِيفَةً مُّوسَى ⑫

69. Ne i thamë: Mos u frikëso! Sigurisht, ti do të jesh mbizotëruesi.

قُلْنَا لَا تَخَفْ إِنَّكَ أَنْتَ الْأَعْلَى ⑬

70. Hidhe atë që ke në dorën e djathtë, ajo do ta gllabërojë gjithçka që ata sajuan. Ajo që sajuan ata është vetëm dredhi magjistari. Dhe magjistari nuk ka sukses, ngado që të vijë.

71. Atëherë magjistarët ranë në sexhde. Thanë: “Besuam në Zotin e Harunit dhe të Musait!”

72. (Faraoni) tha: “A e besuat përpara se t’ju jepja leje?! Ky duhet të jetë i madhi juaj, që jua mësoi magjinë! Unë përnjëmend do t’ju pres duart dhe këmbët të anëve të ndryshme, më pas do t’ju kryqëzoj nëpër trungje hurmash dhe ju do ta mësoni kush prej nesh është më i forti në ndëshkim dhe më i qëndrueshmi!”

73. Ata thanë: “Kurrsesi nuk mund të të japim ty epërsinë mbi shenjat e qarta që na erdhën dhe as mbi Atë që na krijoi. Pra, bëje atë që ke (vendosur) për të bërë! Pa dyshim, ti vendos vetëm për jetën e kësaj bote!

74. Sigurisht, ne e besuam Zotin tonë, që Ai të na falë gabimet tona dhe magjitë që ti na i detyrove. Allahu është më i Miri dhe më i Qëndrueshmi!”

75. Njëmend, ai që arrin te Zoti i tij si fajtor, për të është xhehenemi, në të cilin ai as nuk do të vdesë dhe as nuk do të jetojë.

وَأَلْقَى مَا فِي يَمِينِكَ تَلْقَفَ مَا صَنَعُوا  
إِنَّمَا صَنَعُوا كَيْدَ سِحْرِ ط وَلَا يُفْلِحُ  
السَّاحِرُ حَيْثُ أَتَى ٧٠

فَأَلْقَى السَّحْرَةَ سَجَدًا قَالُوا أَمَّا رَبِّ  
هُرُونَ وَمُوسَى ٧١

قَالَ أَمْتُمْ لَهُ قَبْلَ أَنْ أَدْنِ لَكُمْ ط إِنَّهُ  
لَكَبِيرُكُمْ الَّذِي عَلَّمَكُمُ السِّحْرَ  
فَلَا قِطْعَنَ أَيْدِيكُمْ وَأَرْجَلَكُمْ مِّنْ  
خِلَافٍ وَلَا وَصَلَبْتِكُمْ فِي جُدُوعِ التَّحْلِ  
وَتَعَلَّمَنَّ إِنِّي أَشَدُّ عَذَابًا وَأَبْلَى ٧٢

قَالُوا لَنْ نُؤْتِيكَ عَلَى مَا جَاءَنَا مِنْ  
الْبَيِّنَاتِ وَالَّذِي فَطَرَنَا فَاقْضِ مَا أَنْتَ  
قَاضٍ ط إِنَّمَا تَقْضِي هَذِهِ الْحَيَاةَ الدُّنْيَا ٧٣

إِنَّا أَمَّا بِرَبِّنَا لِنَعْتَفِرَنَّكَ حَطِينًا وَمَا أَكْرَهْتَنَا  
عَلَيْهِ مِنَ السِّحْرِ ط وَاللَّهُ خَيْرٌ وَأَبْلَى ٧٤

إِنَّهُ مَنْ يَأْتِ رَبَّهُ مُجْرِمًا فَإِنَّ لَهُ جَهَنَّمَ ط  
لَا يَمُوتُ فِيهَا وَلَا يَحْيَى ٧٥

76. Kurse ai që arrin tek Ai si besimtar dhe të ketë bërë të mira, për të tillët ka grada të larta;

وَمَنْ يَأْتِهِ مُؤْمِنًا قَدْ عَمِلَ الصَّالِحَاتِ فَأُولَٰئِكَ لَهُمُ الدَّرَجَاتُ الْعُلَىٰ ﴿٧٦﴾

77. xhenete të përhershme nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Në to do të jetojnë përgjithmonë. Ky është shpërblimi i atij që u delirësua.

جَنَّاتٍ عَدْنٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا ۗ وَذَٰلِكَ جَزَاؤُا مَنْ تَرَكَتِ ۖ ﴿٧٧﴾

78. Ne i shpallëm Musait: “Nisu me robërit e Mi gjatë natës dhe çelu një rrugë të thatë në det. Nuk do të kesh as frikë se do t’ju zënë dhe as nuk do të trembesh.”

وَلَقَدْ أَوْحَيْنَا إِلَىٰ مُوسَىٰ أَنْ أَسْرِ بِعِبَادِي فَاصْرَبْ لَهُمْ طَرِيقًا فِي الْبَحْرِ يَبَسًا لَا تَخَفْ دَرَكًا وَلَا تَخْشَىٰ ﴿٧٨﴾

79. Faraoni, bashkë me ushtritë e tij, i ndoqën, atëherë, i mbuloi në det ajo që do t’i mbulonte.

فَاتَّبَعَهُمْ فِرْعَوْنُ بِجُودِهِ فَعَسَيْتُمْ مِّنَ الْيَمِّ مَاعْشِيَهُمْ ﴿٧٩﴾

80. Faraoni e çoi në humbje popullin e tij dhe nuk e udhëzoi.

وَأَصَلَ فِرْعَوْنُ قَوْمَهُ وَمَا هَدَىٰ ﴿٨٠﴾

81. O bijtë e Izraelit! Ne ju shpëtuam nga armiku juaj, lidhëm besë me ju në anën e djathtë të Turit dhe ju zbritëm *manën* dhe *selvanë*.<sup>5</sup>

يَبْنَىٰ إِسْرَائِيلَ قَدْ أَنْجَيْنَاكُمْ مِّنْ عَدُوِّكُمْ وَوَعَدْنَاكُمْ جَانِبَ الطُّورِ الْأَيْمَنِ وَنَزَّلْنَا عَلَيْكُمُ الْمَنَّاءَ وَالسَّلْوَىٰ ﴿٨١﴾

82. Nga ajo që ju kemi dhënë, hani të pastrat dhe mos e teproni në të, se përndryshe, do t’ju zërë ndëshkimi Im. Njëmend, atë që e zë ndëshkimi Im, shkatërrohet.

كُلُوا مِنْ طَيِّبَاتِ مَا رَزَقْنَاكُمْ وَلَا تَطْغَوْا فِيهِ فَيَحِلَّ عَلَيْكُمْ غَضَبِي ۖ وَمَنْ يَحِلِّ عَلَيْهِ غَضَبِي فَقَدْ هَوَىٰ ﴿٨٢﴾

83. Dhe sigurisht, Unë jam shumë Falës për atë që pendohet, beson dhe bënë të mira dhe më pas qëndron në udhëzim.

وَإِنِّي لَغَفَّارٌ لِّمَنْ تَابَ وَآمَنَ وَعَمِلَ صَالِحًا ثُمَّ اهْتَدَىٰ ﴿٨٣﴾

5. Për *manën* dhe *selvanë*, lexoni 2:58.

84. “Dhe çfarë të bëri, o Musa, që të largoheshe nxitimthi nga populli yt?”

وَمَا أَجَلَكَ عَنْ قَوْمِكَ يَمُوسَى ﴿٨٤﴾

85. Ai tha: “Ata janë në gjurmët e mia, kurse unë, o Zoti im, u nxitova drejt Teje që Ti të kënaqesh.”

قَالَ هُمْ أَوْلَاءِ عَلَىٰ أَثَرِي وَعَجِلْتُ إِلَيْكَ رَبِّ لِتَرْضَىٰ ﴿٨٥﴾

86. (Zoti) tha: “Ne e sprovuam popullin tënd në mungesën tënde dhe ata i devijoi Samiriu.”

قَالَ فَإِنَّا قَدْ فَتَنَّا قَوْمَكَ مِنْ بَعْدِكَ وَأَصْلَهُمُ السَّامِرِيُّ ﴿٨٦﴾

87. Atëherë Musai u kthye i zemëruar (dhe) i brengosur te populli i tij. Tha: “O populli im! A nuk ju kishte bërë Zoti juaj një premtim të mirë?! A ju ka zgjatur shumë përmbushja e premtimit apo keni dashur që t’ju zërë ndonjë ndëshkim prej Zotit tuaj dhe për këtë ju e keni shkelur premtimin tim?!”

فَرَجَعَ مُوسَىٰ إِلَىٰ قَوْمِهِ غَضْبَانَ أَسِفًا ۚ قَالَ يَقَوْمِ أَلَمْ يَعِدْكُمْ رَبُّكُمْ وَعَدًّا حَسًّا ۗ أَفَطَالَ عَلَيْكُمُ الْعَهْدُ أَمْ أَرَدْتُمْ أَن يَحِلَّ عَلَيْكُمْ غَضَبٌ مِّن رَّبِّكُمْ فَأَخْلَفْتُم مَّوْعِدِي ﴿٨٧﴾

88. Ata thanë: “Ne nuk e kemi shkelur premtimin tënd me vullnetin tonë, por neve na ishte ngarkuar barra e stolive të popullit dhe ne e hodhëm atë. Kështu hodhi (propozimin) Samiriu.<sup>6</sup>

قَالُوا مَا أَخْلَفْنَا مَوْعِدَكَ بِمَلِكِنَا وَلَكِنَّا حَمَلْنَا أَوْزَارًا مِّن زِينَةِ الْقَوْمِ فَقَذَفْنَاهَا فَكَذَلِكَ أَلْقَى السَّامِرِيُّ ﴿٨٨﴾

89. Më pas ai u bëri një trup viçi që pëlliste.<sup>7</sup> Atëherë ata zunë të thoshin ky është i adhureshmi juaj dhe i adhureshmi i Musait. Pra, ai harroi.”

فَأَخْرَجَ لَهُمْ عِجْلًا جَسَدًا لَهُ خُورٌ فَقَالُوا هَذَا إِلَهُكُمْ وَإِلَهُ مُوسَىٰ فَنَسِيَ ﴿٨٩﴾

6. Populli i Musait mbartte me vete stolitë, që për ta ishin një ngarkesë. Samiriu i nxiti që stolitë t’ia dorëzonin atij që ai të bënte prej tyre një viç si zot për ta. Kur erdhi Hazret Musai<sup>as</sup> i zemëruar, populli i tij tentoi ta justifikonte dorëzimin e stolive dhe marrjen për zot të viçit me pretekstin që ato ishin shumë të rënda për ta dhe se donin ta hiqnin këtë barrë.

7. D.m.th. ky viç artificial ishte ndërtuar në atë mënyrë që kur ajri hynte në të nga njëra anë e tij, nga ana tjetër dilnin fishkëllima, sikur shohim në disa lodra mekanizëm të tillë.

90. A nuk shikonin që ai (trup) nuk iu përgjigjej atyre për asnjë fjalë dhe nuk mund t'u sillte as dëm e as dobi?!

أَفَلَا يَرَوْنَ أَلَّا يَرْجِعُ إِلَيْهِمْ قَوْلًا وَلَا  
يَمْلِكُ لَهُمْ صَرًّا وَلَا نَفْعًا ۝

91. Edhe Haruni u kishte thënë më parë: “O populli im! Jeni sprovuar me anë të tij dhe sigurisht, Zoti juaj është i Gjithëmëshirshmi, andaj, më ndiqni mua dhe bindjuni urdhrin tim.”

وَلَقَدْ قَالَ لَهُمْ هَارُونُ مِنْ قَبْلُ يَقُومُ إِلَيْكُمْ  
فَتَنْتُمْ بِهِ ۚ وَإِنَّ رَبَّكُمُ الرَّحْمَنُ فَاتَّبِعُونِي  
وَاطِيعُوا أَمْرِي ۝

92. Ata thanë: “Ne do të vijojmë të rrimë ulur përpara këtij, derisa të na kthehet Musai.”

قَالُوا لَنْ نُبْرَحَ عَلَيْهِ عَاكِفِينَ حَتَّىٰ يَرْجِعَ  
إِلَيْنَا مُوسَىٰ ۝

93. (Musai) tha: “O Harun! Çfarë të pengoi (t'i ndaloje) kur i pe që devijuan,

قَالَ لَهُرُونَ مَا مَنَعَكَ إِذْ رَأَيْتَهُمْ ضَلُّوا ۝

94. (dhe) të më ndiqje mua?! A kundërshtove urdhrin tim?!”

أَلَا تَتَّبِعَنِ ۖ أَفَعَصَيْتَ أَمْرِي ۝

95. Ai tha: “O biri i nënës sime! Mos më kap mua as për mjekre, as për koke. Unë pata frikë se do të (më) thoshe – Ke krijuar ndasi mes bijve të Izraelit dhe nuk ke pritur vendimin tim!”

قَالَ يَبْنَؤُمَّ لَا تَأْخُذْ بِلِحْيَتِي وَلَا بِرَأْسِي ۚ  
إِنِّي خَشِيتُ أَنْ تَقُولَ فَرَّقْتَ بَيْنَ بَنِي  
إِسْرَائِيلَ وَلَمْ تَرْقُبْ قَوْلِي ۝

96. (Musai) tha: “Si është çështja jote, o Samiri?”

قَالَ فَمَا خَطْبُكَ يَا سَامِرِيُّ ۝

97. Ai tha: “Unë pashë diçka që këta nuk e panë dot (të tjerët). Mora diçka nga gjurmët e të Dërguarit dhe më pas e hodha. E kështu më bëri joshëse vetja ime.”

قَالَ بَصُرْتُ بِمَا لَمْ يَبْصُرُوا بِهِ فَقَبَضْتُ  
قَبْضَةً مِّنْ أَثَرِ الرَّسُولِ فَنَبَذْتُهَا وَكَذَلِكَ  
سَوَّلَتْ لِي نَفْسِي ۝

98. Ai tha: “Shko atëherë (nga këtu), gjatë gjithë jetës do të thuash – Mos më prekni! Ty të premtohet një afat që nuk do të shkelet. Shikoje edhe të adhuruarin tënd, përpara të cilit ke qëndruar ulur. Ne do ta shkrumbojmë atë dhe do ta shpërndajmë mirë në det.”<sup>8</sup>

قَالَ فَاذْهَبْ فَإِنَّ لَكَ فِي الْحَيَاةِ أَنْ  
تَقُولَ لَا مِسَاسَ وَإِنَّ لَكَ مَوْعِدًا لَنْ  
نُخْلَفَهُ ۚ وَانظُرْ إِلَى إِلٰهِكَ الَّذِي ظَلْتَ  
عَلَيْهِ عَاكِفًا لَنُحَرِّقَنَّهُ ثُمَّ لَنَنْسِفَنَّهُ فِي  
الْيَمِّ نَسْفًا ﴿٧٨﴾

99. Pa dyshim, i Adhurueshmi juaj është Allahu, nuk ka të adhureshëm tjetër përveç Atij. Ai përfshin çdo gjë me dije.

إِنَّمَا إِلٰهُكُمُ اللّٰهُ الَّذِي لَا إِلٰهَ إِلَّا هُوَ ۖ وَسِعَ  
كُلَّ شَيْءٍ عِلْمًا ﴿٧٩﴾

100. Kështu të rrëfejmë ty ngjarjet e së kaluarës. Sigurisht, Ne nga ana Jonë ty të dhamë (Librin si) këshillë.

كَذٰلِكَ نَقُصُّ عَلَيْكَ مِنْ اٰبَآءٍ مَا قَدْ سَبَقَ ۗ  
وَقَدْ اٰتَيْنٰكَ مِنْ لَدُنَّا ذِكْرًا ﴿٨٠﴾

101. Ai që i shmanget asaj, patjetër do të ngrëjë një barrë Ditën e Kiametit.

مَنْ اَعْرَضَ عَنْهُ فَاِنَّهُ يَحْمِلُ يَوْمَ الْقِيٰمَةِ  
وِزْرًا ﴿٨١﴾

102. Ata në të do të mbesin gjatë. Çfarë barre e keqe do të jetë për ta Ditën e Kiametit!

خٰلِدِيْنَ فِيْهِ ۗ وَسَآءَ لَھُمْ يَوْمَ الْقِيٰمَةِ حِمْلًا ﴿٨٢﴾

103. Ditën kur do t'i fryhet bririt dhe do t'i grumbullojmë fajtorët, atë ditë, sykaltërtit.<sup>9</sup>

يَوْمَ يَنْفَعُ فِي الصُّوْرِ وَيَحْشُرُ الْمُجْرِمِيْنَ  
يَوْمَئِذٍ زُرْقًا ﴿٨٣﴾

8. Për shkak të këtij veprimi të Samirit, *Hazret Musai*<sup>as</sup> i tha: Gjersa të rrosh, vetë do t'u thuash njerëzve: “Mos më prekni!”. Kjo tregon se atij mund t'i ketë rënë lebra dhe ai u detyrua t'u thoshte vetë njerëzve të mos i afroreshin e të mos e preknin, që të mos u ngjitej edhe atyre e njëjta gjë. Kështu ndodhte edhe në Europë deri në shekullin e kaluar. Të lebrosurit ishin të detyruar të mbanin zile nëpër qafë, në mënyrë që kalimtarët që nga larg të kuptonin se po kalojnë ata që e kanë këtë sëmundje.

9. Fjala *zurkan* do të thotë “sykaltër” dhe ndoshta u referohet popujve perëndimorë të krishterë, ku shumica janë sykaltër.



104. Ata do të pëshpëritin me njëri-tjetrin: Ju keni qëndruar vetëm dhjetë (ditë)!<sup>10</sup>

يَتَخَفَتُونَ بَيْنَهُمْ إِنْ لَبِثْتُمْ إِلَّا عَشْرًا ﴿١٠﴾

105. Ne e dimë më së miri se çfarë do të thonë ata. Kur më i miri prej tyre për nga drejtimi do të thotë: “Ju keni qëndruar vetëm një ditë!”

نَحْنُ أَعْلَمُ بِمَا يَقُولُونَ إِذْ يَقُولُ أَمْثَلُهُمْ طَرِيقَةً إِنْ لَبِثْتُمْ إِلَّا يَوْمًا ﴿١١﴾

106. Dhe të pyesin ty për malet. Atëherë thuaj: Zoti im do t'i thërrmojë ato tërësisht.

وَيَسْأَلُونَكَ عَنِ الْجِبَالِ فَقُلْ يَنْسِفُهَا رَبِّي نَسْفًا ﴿١٢﴾

107. Më pas do t'i lërë rrafsh të shkretë.

فَيَذَرُهَا قَاعًا صَفْصَفًا ﴿١٣﴾

108. Nuk do të shohësh në të shtrembësi e as ulje-ngritje.

لَا تَرَى فِيهَا عِوَجًا وَلَا أَمْتًا ﴿١٤﴾

109. Ditën kur ata do ta ndjekin thirrësin që nuk ka asnjë shtrembësi. Zërat do të ulen për nder të të Gjithëmëshirshmit, atëherë nuk do të dëgjosh asgjë përveç pëshpëritjes.<sup>11</sup>

يَوْمَئِذٍ يَتَّبِعُونَ الدَّاعِيَ لَا عِوَجَ لَهُ<sup>١٥</sup> وَخَشَعَتِ الْأَصْوَاتُ لِلرَّحْمَنِ فَلَا تَسْمَعُ إِلَّا هَمْسًا ﴿١٥﴾

110. Ditën kur nuk do të vlejë ndërmjetësimi, përveç atij për të cilin i Gjithëmëshirshmi do të lejojë dhe për të cilin do të japë pëlqimin të thuhet.

يَوْمَئِذٍ لَا تَنْفَعُ الشَّفَاعَةُ إِلَّا مَنْ أَذِنَ لَهُ الرَّحْمَنُ وَرَضِيَ لَهُ قَوْلًا ﴿١٦﴾

10. Ditën e Gjykimit, kohën e madhështisë së tyre në këtë botë ata do ta shohin nga lart dhe do të pëshpëritin se sundimi i tyre nuk ka qenë më shumë se dhjetë, që do të thotë dhjetë shekuj. Kjo vërtetohet edhe nga historia e sundimit të krishterë që dhjetë shekuj ishte periudha e triumfit të tyre. Tre shekuj pas Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, popujt e krishterë perëndimorë patën lulëzim përreth dhjetë shekuj dhe më pas filluan të kenë rënie.

11. D.m.th. kur do të vijë ky shkatërrim, edhe superfuqitë që u ngjajnë maleve, do të rrëzohen dhe do të rrafshohen. Atëherë njerëzit do të fillojnë ta dëgjojnë Profetin e kohës, në mësimet e të cilit, nuk ka asnjë shtrembësi, pra Profetin Muhammed<sup>savs</sup>, sepse Kurani i Shenjtë që iu zbrit atij, nuk ka shtrembësi.

111. Ai di gjithçka që është para tyre dhe gjithçka që është pas tyre dhe ata nuk mund ta përfshijnë dot Atë me dije.

يَعْلَمُ مَا بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَمَا خَلْفَهُمْ وَلَا يُحِيطُونَ بِهِ عِلْمًا ﴿١١١﴾

112. Fytyrat do të ulen përpara të Gjallit, të Qëndrueshmit dhe do të dështojë ai që do të mbartë padrejtësi.

وَعَنَتِ الْوُجُوهُ لِلْحَيِّ الْقَيُّومِ ۖ وَقَدْ خَابَ مَنْ حَمَلَ ظُلْمًا ﴿١١٢﴾

113. Kurse ai që bën të mira dhe është edhe besimtar, nuk do të ketë frikë as nga padrejtësia, e as nga nënvlerësimi.

وَمَنْ يَعْمَلْ مِنَ الصَّالِحَاتِ وَهُوَ مُؤْمِنٌ فَلَا يَخَفُ ظُلْمًا وَلَا هَضْمًا ﴿١١٣﴾

114. Ne kështu e zbritëm këtë si një Kuran elokuent dhe shpjeguam çdo paralajmërim në të, që ata të kenë drojë (ndaj Zotit) ose Ai t'u tregojë atyre një mësim.

وَكَذَلِكَ أَنْزَلْنَاهُ قُرْآنًا عَرَبِيًّا وَوَصَرَفْنَا فِيهِ مِنَ الْوَعِيدِ لَعَلَّهُمْ يَتَّقُونَ أَوْ يُحَدِّثُ لَهُمْ زِكْرًا ﴿١١٤﴾

115. Andaj, i lartë është Allahu, Sunduesi i Vërtetë. Mos u nxito me (përsëritjen) e Kuranit përpara se të të përmbushet shpallja e tij. Dhe thuaj: “O Zoti im! Më shto dijen mua!”

فَتَعَلَى اللَّهِ الْمَلِكُ الْحَقُّ ۚ وَلَا تَعْجَلْ بِالْقُرْآنِ مِنْ قَبْلِ أَنْ يُقْضَىٰ إِلَيْكَ وَحْيُهُ ۚ وَقُلْ رَبِّ زِدْنِي عِلْمًا ﴿١١٥﴾

116. Sigurisht, më përpara Ne i premtuam edhe Ademit, por ai harroi dhe Ne nuk gjetëm tek ai vullnet (për ta shkelur premtimin).

وَلَقَدْ عَاهَدْنَا إِلَىٰ آدَمَ مِنْ قَبْلِ فَسَىٰ وَلَمْ نَجِدْ لَهُ عَزْمًا ﴿١١٦﴾

117. Dhe kur u thamë engjëjve: “Bëni sexhde për Ademin!”, ata bënë sexhde, përveç Iblisit. Ai mohoi.

وَإِذْ قُلْنَا لِلْمَلَائِكَةِ اسْجُدُوا لِآدَمَ فَسَجَدُوا إِلَّا إِبْلِيسَ أَبَى ﴿١١٧﴾

118. Atëherë thamë: “O Adem! Njëmend, ky është armiku yt dhe i gruas sate. Le të mos ju dëbojë ju prej

فَقُلْنَا يَا آدَمُ إِنَّ هَذَا عَدُوٌّ لَكَ وَلِرَوْحِكَ

xhenetit në asnjë mënyrë, sepse do të mjerohesh.<sup>12</sup>

فَلَا يُخْرِجَنَّكَمَا مِنَ الْجَنَّةِ فَتَشْفَىٰ ﴿١١٨﴾

119. Është (caktuar) për ty të mos jesh në të as i uritur, as i zhveshur.

إِنَّ لَكَ أَلَّا تَجُوعَ فِيهَا وَلَا تَعْرَىٰ ﴿١١٩﴾

120. Dhe (gjithashtu) të mos jesh në të as i etur dhe as i lënë në diell.<sup>13</sup>

وَأَنَّكَ لَا تَظْمَأُ فِيهَا وَلَا تَصْحَىٰ ﴿١٢٠﴾

121. Djalli i cyti ata të dy. Tha: “O Adem! A të njoftoj ty për pemën e përjetësisë dhe për një sundim që nuk bie?!”

فَوَسْوَسَ إِلَيْهِ الشَّيْطَانُ قَالَ يَا آدَمُ هَلْ أَدُلُّكَ عَلَى شَجَرَةِ الْخُلْدِ وَمُلْكٍ لَّا يَبْلَىٰ ﴿١٢١﴾

122. Ata të dy hëngrën nga ajo. Atëherë iu shfaqën të turpshmet e tyre dhe ata zunë ta mbulonin veten me gjethet e xhenetit.<sup>14</sup> Ademi nuk iu bind Zotit të tij, prandaj devijoi.

فَأَكَلَا مِنْهَا فَبَدَتَ لُهُمَا سَوَآتُهُمَا وَطَفَقَا يَخْصِفْنَ عَلَيْهِمَا مِنْ وَّرَقِ الْجَنَّةِ وَعَصَىٰ آدَمُ رَبَّهُ فَغَوَىٰ ﴿١٢٢﴾

12. Këtu fjala *xhenet* nuk mund t'i referohet qiellit sepse: së pari, Kurani deklaron qysh në fillim që Ademi u krijua në Tokë (2:37); së dyti, xheneti i botës së përtejme është një vend nga i cili, sipas Kuranit, askush nuk dëbohet kurrë pasi të ketë hyrë një herë në të (15:49), ndërsa *xhenetin* ku qe Ademi, u detyrua ta linte (2:37), siç e pohon edhe ky ajet.

13. Ajetet 119 – 120 flasin për nevojat jetike të një qytetërimi. Sigurimi i ushqimit, i ujit, i veshmbathjes dhe i strehimit për të gjithë qytetarët është detyra e parë e një shteti dhe se një shoqëri mund të quhet e qytetëruar vetëm kur të gjithë anëtarët e saj pajisen me këto domosdoshmëri në mënyrë të denjë. Njerëzimi do të vazhdojë të vuajë nga trazirat sociale për aq kohë sa gjendja e pabarazisë së skajshme ekonomike, e tillë që një pjesë e shoqërisë noton në para dhe një pjesë tjetër vdes urie, nuk përmirësohet. Andaj, Zoti i Madhërisëm porositi Hazret Ademin<sup>as</sup>, Profetin e parë të njerëzimit, të siguronte se nevojat jetike të përmendura në këto ajete, t'i plotësoheshin çdo anëtar të shoqërisë. Këto ishin katër parime themelore të Sheriatit të tij, të cilat do të hidhnin themelet e një shoqërie të zhvilluar.

14. Njeriu kur e përfundon së kryeri mëkatin, atë e vret ndërgjegjja dhe i thotë – sa poshtë ke rënë!; ky veprim nuk të solli asnjë dobi; po të mos e kishe bërë, nuk do të humbje gjë! Atëherë ai e kupton humbjen dhe përpiqet ta fshijë gabimin e tij me veprat e mira, të cilat janë *gjethet e xhenetit*. Pra, përmes pendesës, të shoqëruar me vepra të mira, ai përpiqet ta lajë mëkatin që ka bërë. Për *gjethet* Kurani ka përdorur fjalën arabe *varak*, e cila përveç gjethes, ka edhe kuptimin *zbukurim*. Pra, Ademi dhe Hava filluan të bëjnë vepra, të cilat do t'ua rikthenin bukurinë shpirtërore.

123. Më pas Zoti i tij e zgjodhi, ia pranoi pendesën dhe e udhëzoi.

ثُمَّ اجْتَبَاهُ رَبُّهُ فَتَابَ عَلَيْهِ وَهَدَىٰ ﴿١٢٣﴾

124. Tha: “Ju të dy dilni nga këtu bashkë me të gjithë. Disa prej jush janë armiq për disa të tjerë. Andaj, kurdoherë që do t’ju vijë udhëzim prej Meje, ai që do ta ndjekë udhëzimin Tim, as nuk do të devijojë, as nuk do të mjerohet.

قَالَ اهْبِطَا مِنْهَا جَمِيعًا بَعْضُكُمْ لِبَعْضٍ عَدُوٌّ ۖ فَإِمَّا يَأْتِيَنَّكُمْ مِنِّي هُدًى لِّمَنِ اتَّبَعَ هُدَايَ فَلَا يَضِلُّ وَلَا يَشْغَىٰ ﴿١٢٤﴾

125. Dhe ai që shmanget nga përkujtimi Im, do të ketë jetë të ngushtë dhe, Ditën e Kiametit, atë do ta ngremë të verbër.

وَمَنْ أَعْرَضَ عَن ذِكْرِي فَإِنَّ لَهُ مَعِيشَةً ضَنْكًا ۖ وَنَحْشُرُهُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ أَعْمَىٰ ﴿١٢٥﴾

126. Ai do të thotë: “O Zoti im! Përse më ngrite të verbër, edhe pse kam pasur shikimin?”

قَالَ رَبِّ لِمَ حَشَرْتَنِي أَعْمَىٰ وَقَدْ كُنْتُ بَصِيرًا ﴿١٢٦﴾

127. (Zoti) do të thotë: “Kështu ndodhi. Ty të vinin shenjat e Mia, por ti i harroje. Andaj, sot edhe ti do të harrohesh.”

قَالَ كَذَلِكَ أَتَتْكَ آيَاتُنَا فَنَسِيْتَهَا ۖ وَكَذَلِكَ الْيَوْمَ تُنسىٰ ﴿١٢٧﴾

128. Ne kështu dënojmë atë që e teproi dhe nuk besoi në shenjat e Zotit të tij. Dhe ndëshkimi i *ahiretit* është më i forti dhe më i qëndrueshmi.

وَكَذَلِكَ نَجْزِي مَنْ أَسْرَفَ وَلَمْ يُؤْمِنْ بِآيَاتِ رَبِّهِ ۗ وَلَعَذَابُ الْآخِرَةِ أَشَدُّ وَأَبْغَىٰ ﴿١٢٨﴾

129. A nuk i udhëzoi ata fakti se sa shumë brezni kemi shkatërruar para tyre, të cilët ecnin (lirisht) nëpër vendbanimet e tyre?! Në të ka shenja për të mençurit.

أَفَلَمْ يَهْدِ لَهُمْ كَمْ أَهْلَكْنَا قَبْلَهُمْ مِنَ الْقُرُونِ يَمْشُونَ فِي مَسْجِنِهِمْ ۗ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِّأُولِي التَّنْذِيرِ ﴿١٢٩﴾

130. Sikur të mos ishte lëshuar (një) fjalë paraprake prej Zotit tënd dhe një afat i caktuar, atëherë (ndëshkimi) do t’u ngjitej menjëherë.

وَلَوْ لَا كَلِمَةٌ سَبَقَتْ مِنْ رَبِّكَ لَكَانَ لِزَامًا ۖ وَأَجَلٌ مُّسَمًّىٰ ﴿١٣٠﴾

131. Prandaj, duro për atë që ata thonë dhe përkujo Zotin tënd me lavdinë (e Tij) përpara lindjes së diellit dhe përpara perëndimit të tij; po ashtu përkujoje gjatë orëve të natës dhe gjatë pjesëve të ditës, që ti të jesh i kënaqur.<sup>15</sup>

فَاصْبِرْ عَلَى مَا يَقُولُونَ وَسَبِّحْ بِحَمْدِ رَبِّكَ  
قَبْلَ طُلُوعِ الشَّمْسِ وَ قَبْلَ غُرُوبِهَا  
وَمِنْ أَنَايِ الْأَيِّ فَسَبِّحْ وَأَطْرَافِ النَّهَارِ  
لَعَلَّكَ تَرْضَى ﴿١٣١﴾

132. Dhe mos i hap sytë ndaj asaj që u kemi dhënë disa prej grupeve të tyre si zbukurim të jetës së kësaj bote, që t'i sprovovmë në të. Të mirat e Zotit tënd janë më të mira dhe më të qëndrueshme.

وَلَا تَمُدَّنَّ عَيْنَيْكَ إِلَى مَا مَتَّعْنَا بِهِ أَزْوَاجًا  
مِّنْهُمْ زَهْرَةَ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا لِنَفْتِنَهُمْ فِيهِ  
وَرِزْقُ رَبِّكَ خَيْرٌ وَأَبْقَى ﴿١٣٢﴾

133. Porosit familjen tënde për namazin dhe ji i qëndrueshëm në të. Ne nuk të kërkujmë ushqimin. Ne të ushqejmë ty. Fundi i përket druajtjes (ndaj Zotit).

وَأْمُرْ أَهْلَكَ بِالصَّلَاةِ وَاصْطَبِرْ عَلَيْهَا لَا  
نَسْأَلُكَ رِزْقًا نَحْنُ نَرْزُقُكَ وَالْعَاقِبَةُ  
لِلَّتَّقَى ﴿١٣٣﴾

134. Ata thonë: “Ai përse nuk na sjell ndonjë shenjë prej Zotit të tij?” Vallë, a nuk u erdhi prova e qartë që gjendet (edhe) në shkrimet e para?!

وَقَالُوا لَوْلَا يَأْتِينَا بِآيَةٍ مِّن رَّبِّهِ لَأَوَلَّمْ  
تَأْتِيهِمْ بَيِّنَةٌ مَّا فِي الصُّحُفِ الْأُولَى ﴿١٣٤﴾

135. Dhe po t'i kishim shkatërruar ata me ndonjë ndëshkim përpara kësaj, do të thoshin patjetër: “O Zoti ynë: Pse nuk na dërgove ndonjë të dërguar, që të ndiqnim ajetet e Tua përpara se të turpëroheshim e të poshtëroheshim”.

وَلَوْ أَنَّا أَهْلَكْنَاهُمْ بِعَذَابٍ مِّن قَبْلِهِ لَقَالُوا  
رَبَّنَا لَوْلَا أَرْسَلْتَ إِلَيْنَا رَسُولًا فَنَتَّبِعَ آيَاتِكَ  
مِّن قَبْلِ أَنْ نَذِلَّ وَنَحْزَى ﴿١٣٥﴾

15. Disa komentues të Kuranit janë të mendimit se ky ajet flet për namazet e pesë vakteve. Koha “përpara lindjes së diellit” është e namazit të sabahut; “përpara perëndimit të tij” namazi i ikindisë; “gjatë orëve të natës” janë namazi i akshamit dhe i jacisë; kurse “gjatë pjesëve të ditës” është koha e namazit të drekës. Por çfarëdo që të nënkuptojnë fjaltë e ajetit, është mjaft e qartë se për të arritur suksesin dhe qetësinë e mendjes, është shumë e nevojshme ta kujtojmë Zotin dhe ta lavdërojmë Atë. Përkujtimi i vazhdueshëm i Zotit është një mjet shumë i rëndësishëm për të pasur dritën shpirtërore dhe qetësinë mendore. Lexoni 4:104 dhe 22:27.

136. Thuaj: Çdokush është duke pritur, andaj, prisni edhe ju. Do të mësoni patjetër se cilët janë njerëzit e rrugës së drejtë dhe cilët u udhëzuan.

قُلْ كُلٌّ مُتَرَبِّصٌ فَتَرَبَّصُوا ۚ فَسَتَعْلَمُونَ  
 ۙ مَنْ أَصْحَابُ الصِّرَاطِ السَّوِيِّ وَمَنِ اهْتَدَى ۗ ﴿١٣٦﴾

## Surja 21 – El-Enbija

Surja El-Enbija është mekase dhe ajo zbriti në vitin e katërt ose të pestë pas profetërisë. Bashkë me *bismil-lahin* ajo ka njëqind e trembëdhjetë ajete.

Në fund të sures paraardhëse u fol për llogarinë, që njerëzit do të përgjigjen për veprat e tyre, dhe u tha: ti, o Muhammed, do ta shohësh se pikërisht ti je në rrugën e drejtë. Kurse kjo sure hap fjalën duke thënë se Ora e llogaridhënies erdhi, por shumica janë të shkujdesur ndaj saj.

Kjo sure pohon se edhe para Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, Zoti i Madhërishëm dërgoi vetëm burra si profetë dhe se asnjërit prej tyre nuk i dha trup që nuk hante ushqim. Në këtë kontekst, ajetet në fjalë hedhin poshtë besimin se *Hazret Isai* (Jezusi)<sup>as</sup> të ishte Zot, sepse edhe ai gjatë gjithë jetës së tij, ushqehet.

Menjëherë pas kësaj, kjo sure thotë që njerëzit naivë ngritën zota nga toka, dhe më pas jep një argument të fuqishëm se nuk mund të jenë dy Zota në asnjë mënyrë. Ajeti në fjalë thotë se po të kishte dy Zota, pra qoftë një më shumë, do të ndodhte një çrregullim i madh nëpër qiej dhe tokë, sepse çdo Zot do të veçohet me krijesat e veta dhe sistemi i universit do të pësonte avari dhe prishje të tillë, që kurrë nuk mund të ndreqet. Por në univers, kudo që shohim, nuk gjejmë asnjë cen. Prandaj, thotë, “Ne edhe para teje kemi dërguar të dërguar dhe atyre të gjithëve iu shpallëm se nuk ka zot tjetër përveç Allahut”.

Ajeti 27 përmend doktrinën e rreme të atyre që thonë: “Allahu ka marrë bir”. Por kur një krijesë, qoftë ai profet, merret si bir i Zotit, numri i bijve të tillë fillon të shtohet. Prandaj, pas kësaj teme, kjo sure pohon që përveç *Hazret Isait*<sup>as</sup>, edhe shumë robër të tjerë të Allahut, njerëzit i kanë marrë si të barabartë me Allahun.

Pas kësaj vjen ajeti që zbulon një sekret të tillë të universit, të cilin njeriu i asaj kohe as nuk mund ta imagjinonte dot. Ajeti pohon: I gjithë universi ishte i mbyllur fort në një rreth të tillë që asgjë nuk mund të dilte jashtë tij. Zoti i Madhërishëm thotë: Ne i kemi çelur ato. Më pas tha se uji është baza e jetës dhe tha që përmes maleve të ngulitura (*ravasi*) u vendos sistemi i ciklimit të ujit. Gjithashtu, ajetet në vijim tregojnë se si qielli mbron tokën dhe banorët e saj dhe tregon sesi toka dhe gjithçka që është në qiej lëvizin pa ndalesë. Kjo sure na tërheq vëmendjen që ashtu siç toka dhe qiejt nuk janë të përhershme, edhe njeriu nuk do të jetë i tillë. “O i Dërguar! Askush para teje nuk ka gëzuar përjetësi!”.

Më pas, kjo sure flet për Profetët përpara Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, sesi ata patën bekimin e të Gjithëmëshirshmit (*Rrahman*). Përmend edhe ligjin e pakthyeshmë që kur njerëzit e një vendbanimi shkatërrohen dhe asgjësohen, nuk kthehen më në të. Edhe kur do të vinte koha e Jexhuxhëve dhe e Mexhuxhëve, shkencëtarët do të pretendonin të ringjallnin të vdekurit, por nuk do ta arrijnë këtë.

Po kjo sure flet edhe për palosjen e qiejve dhe të tokës dhe gjithashtu thotë që ky univers nuk do të ekzistojë pafund, por Zoti i Madhërishëm do të krijojë përsëri univers tjetër nga universi që do të asgjësohet. Allahu i Madhërishëm është i Plotfuqishëm ta përsërisë krijimin.

Në këtë sure thuhet që Profeti Muhammed<sup>savs</sup> është pasqyrim i Zotit të Gjithëmëshirshëm, pra thotë: Ne ty të kemi Dërguar si mëshirë për të gjitha botët.

Në fund lexojmë ajetin ku shohim se *Hazret* Profeti Muhammed<sup>savs</sup> i lutet Zotit të Madhërishëm: Vendos mes meje dhe mohuesve të mi me drejtësi! Dhe ngaqë ai është përfaqësues i të Gjithëmëshirshmit, i drejtohet botës duke thënë se Zoti i Gjithëmëshirshëm nuk do ta lërë atë vetëm, sepse është pasqyrë e mëshirës së Tij të pakufishme për të gjithë botën.

Surja pasardhëse është El-Haxh, e cila është dëshmi e përsosur që *Hazret* Profeti Muhammed<sup>savs</sup> ka ardhur si mëshirë për botët, dhe Qabja, Shtëpia e Allahut, është i vetmi vend ku njerëzit nga e gjithë bota vijnë për të bërë haxh.





1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Për njerëzit u afrua llogaridhënia e tyre, kurse ata janë në shkujdesje, duke e kthyer shpinën.

إِنَّمَا أَقْرَبَ لِلنَّاسِ حِسَابُهُمْ وَهُمْ فِي غَفْلَةٍ ②  
مُعْرِضُونَ ③

3. Sa herë që u vjen ndonjë këshillë e re prej Zotit të tyre, ata vetëm se e dëgjojnë sikur po luajnë,

مَا يَأْتِيهِمْ مِّنْ ذِكْرٍ مِّن رَّبِّهِمْ مُّحَدَّثٍ إِلَّا اسْتَمَعُوهُ وَهُمْ يَلْعَبُونَ ④

4. duke pasur zemrat në harresë. Dhe ata që bënë padrejtësi, i kanë mbajtur të fshehta pëshpëritjet. “A nuk qenka ky një njeri sikur ju?! A po shkoni pas magjisë, edhe pse e shikoni?!”

لَا هِيَةَ قُلُوبُهُمْ ⑤ وَأَسْرُوا النَّجْوَى ⑥  
الَّذِينَ ظَلَمُوا هَلْ هَذَا إِلَّا بَشْرٌ مِّثْلَكُم ⑦ أَفَتَأْتُونَ السَّحَرَ وَأَنْتُمْ تَبْصُرُونَ ⑧

5. Ai tha: Zoti im e di çdo thënie që është në qiell e tokë dhe Ai është Gjithëdëgjuesi, i Gjithëdijshmi.

قُلْ رَبِّي يَعْلَمُ الْقَوْلَ فِي السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ ⑨  
وَهُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ ⑩

6. Madje, ata thanë: “Këto janë ëndrra të ngatërruara!” Madje, thanë: “Ai e trilloi këtë!” Madje thanë: “Ai është poet, andaj, le të na sjellë ndonjë shenjë, siç u dërguan të parët!”

بَلْ قَالُوا أَضْغَاثُ أَحْلَامٍ بَلْ افْتَرَاهُ بَلْ هُوَ شَاعِرٌ ⑪ فَلْيَأْتِنَا بِآيَةٍ كَمَا أُرْسِلَ الْأَوْلُونَ ⑫

7. Asnjëra nga vendbanimet që Ne shkatërruam, nuk kishte besuar. A do të besojnë këta?!

مَا أَمَنْتَ قَبْلَهُمْ مِّنْ قَرْيَةٍ أَهْلَكْنَاهَا ⑬  
أَفَهُمْ يُؤْمِنُونَ ⑭

8. Dhe përpara teje nuk dërguam askënd përveç burrave, të cilëve iu shpallnim. Prandaj, pyetni njerëzit

وَمَا أَرْسَلْنَا قَبْلَكَ إِلَّا رِجَالًا نُّوحِي إِلَيْهِمْ فَسَلُّوا أَهْلَ الذِّكْرِ إِنْ كُنْتُمْ لَا

e këshillës (pra, të Librit) nëse nuk dini.

تَعْلَمُونَ ﴿٥٠﴾

9. Dhe ata nuk i bëmë trupa që nuk hanin ushqim dhe ata as nuk ishin të përjetshëm.<sup>1</sup>

وَمَا جَعَلْنَاهُمْ جَسَدًا لَّا يَأْكُلُونَ الطَّعَامَ  
وَمَا كَانُوا خَالِدِينَ ﴿٥١﴾

10. Më pas Ne atyre ua përmbushëm premtimin, pra, shpëtuan ata që deshëm, kurse shkelësit i shkatërruam.

ثُمَّ صَدَقْنَاهُمُ الْوَعْدَ فَأَنْجَيْنَاهُمْ وَمَنْ نَشَاءُ  
وَأَهْلَكْنَا الْمُسْرِفِينَ ﴿٥٢﴾

11. Njëmend, juve ju kemi zbritur një Libër, në të cilin ka këshillë për ju. A nuk kuptoni?!

لَقَدْ أَنْزَلْنَا إِلَيْكُمْ كِتَابًا فِيهِ ذِكْرُكُمْ  
لَعَلَّكُمْ تَعْقِلُونَ ﴿٥٣﴾

12. Sa shumë vendbanime që ishin keqbërëse kemi shkatërruar, dhe pas tyre krijuam popuj të tjerë!

وَكَمْ قَصَمْنَا مِنْ قَرْيَةٍ كَانَتْ ظَالِمَةً  
وَأَنْشَأْنَا بَعْدَهَا قَوْمًا آخَرِينَ ﴿٥٤﴾

13. E kur ata e ndien ndëshkimin Tonë, menjëherë filluan të iknin prej tij.

فَلَمَّا أَحْسَبُوا أَنَّنَا إِذَا هُمْ مِنْهَا يَرْكُضُونَ ﴿٥٥﴾

14. “Mos ikni dhe kthehuni atje ku gëzonit pasuri dhe (kthehuni drejt) shtëpive tuaja, që ju të pyeteni.”

لَا تَرْكُضُوا وَارْجِعُوا إِلَى مَا أُتْرِفْتُمْ فِيهِ  
وَمَسْكِنِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَسْأَلُونَ ﴿٥٦﴾

1. Që të besosh se Hazret Isai<sup>as</sup> jeton diku në qiell me trupin e tij tokësor dhe se jeton atje porsì engjëjt, pra, pa pasur nevojë të ushqehet, të duhet ta kundërshtosh edhe këtë ajet të Kuranit, duke hedhur poshtë Fjalën e pastër të Zotit të Madhërishëm, sepse ky ajet pohon për të gjithë Profetët se ata kanë pasur një trup, si gjithë të tjerët, që nuk mund të mbijetonte pa u ushqyer. Realisht, qoftë ky ajet i vetëm është provë e mjaftueshme që sipas Kuranit, Hazret Isai<sup>as</sup> ka ndërruar jetë, sepse është praktikë e Zotit që asnjë trup tokësor nuk rron dot pa ushqimin tokësor. Kjo është praktikë e Allahut. Atëherë Hazret Isai<sup>as</sup> si po jetuaka deri tani në qiell?! Zoti i Madhërishëm thotë “në praktikën e Allahut ti kurrë nuk do të gjesh ndonjë ndryshim.” (33:63). Sikur të mos mjaftonte kjo, Zoti ka pohuar veçanërisht për Hazret Isain<sup>as</sup> edhe faktin se ai ushqehet dikur dhe jo tani. Ai thotë: “Mesihu, biri i Merjemes ishte vetëm një i Dërguar. Të dërguarit para tij kanë kaluar. Nëna e tij ishte e ndershme. Ata të dy hanin ushqim.” (5:76). Tani, për sa kohë që ai nuk ushqehet më, ai nuk ka shkuar me trupin e tij fizik, por ka shkuar me shpirtin e tij, si gjithë të tjerët. Shkurt, që të besosh se Hazret Isai<sup>as</sup> jeton ende në qiell, të duhet t’u kundërvihesh hapur shumë ajeteve të Kuranit të Shenjtë. Lexoni edhe 21:35-36; 5:116-118; 3:56; 3:145.

15. Ata thanë: “Mjerë ne! Kemi qenë vërtet keqbërës!”

قَالُوا يَا بَلَاءَ إِنَّا كُنَّا ظَالِمِينَ ﴿١٥﴾

16. Vetëm kjo ishte thirrja e tyre, derisa Ne i bëmë si arë të korrur e të shkretë.

فَمَا زَالَتْ تِلْكَ دَعْوَاهُمْ حَتَّى جَعَلْنَاهُمْ حَصِيدًا خُمِدِينَ ﴿١٦﴾

17. Qiellin dhe tokën dhe gjithçka që është mes tyre Ne nuk i krijuam duke bërë lojë.

وَمَا خَلَقْنَا السَّمَاءَ وَالْأَرْضَ وَمَا بَيْنَهُمَا لِعِبِينِ ﴿١٧﴾

18. Sikur të donim të kishim ndonjë lojë, atë do ta bënim pranë Vetes Sonë, nëse vërtet do të bënim (një gjë të tillë).

لَوْ أَرَدْنَا أَنْ نَتَّخِذَ لَهُمْ آلًا تَحَدُّثُهُ مِنْ لَدُنَّا إِنَّ كُنَّا لَفَاعِلِينَ ﴿١٨﴾

19. Por Ne e hedhim të vërtetën mbi të rremen, që ajo ta shkelë atë, atëherë (kjo e fundit) papritmas zhduket. Mjerë për ju që përshkruani (gjëra të rreme ndaj Allahut)!

بَلْ نَقْذِفُ بِالْحَقِّ عَلَى الْبَاطِلِ فَيَدْمَغُهُ فَإِذَا هُوَ زَاهِقٌ ۖ وَلَكُمْ الْوَيْلُ مِمَّا تَصِفُونَ ﴿١٩﴾

20. E Atij është ajo që është nëpër qiej e tokë. Dhe ata që janë pranë Tij, nuk mburren nga adhurimi i Tij dhe as nuk lodhen.

وَلَهُ مَنْ فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ۖ وَمَنْ عِنْدَهُ لَا يَسْتَكْبِرُونَ عَنْ عِبَادَتِهِ وَلَا يَسْتَحْسِرُونَ ﴿٢٠﴾

21. Përkujtojnë (Atë) natën dhe ditën, pa lënë mangësi.

يَسْبِحُونَ اللَّيْلَ وَالنَّهَارَ لَا يَفْتُرُونَ ﴿٢١﴾

22. A kanë marrë të adhurueshëm prej tokës që krijuakan?!

أَمْ اتَّخَذُوا إِلَهًا مِنَ الْأَرْضِ هُمْ يُنْشِرُونَ ﴿٢٢﴾

23. Në ato të dyja, po të kishte të adhurueshëm të tjerë përveç Allahut, ato do të shkatërroheshin. Pra, i Pastër është Allahu, Zoti i Arshit, nga ajo që ata i përshkruajnë.

لَوْ كَانَ فِيهِمَا آلِهَةٌ إِلَّا اللَّهُ لَفَسَدَتَا ۗ فَسُبْحَانَ اللَّهِ رَبِّ الْعَرْشِ عَمَّا يَصِفُونَ ﴿٢٣﴾

24. Ai nuk pyetet për atë që bën, kurse ata do të pyeten.

لَا يُسْأَلُ عَمَّا يَفْعَلُ وَهُمْ يُسْأَلُونَ ﴿٢٤﴾

25. A kanë marrë të adhureshëm të tjerë në vend të Tij? Thuaj: Sillni argumentin tuaj! Ky është kujtim i atyre që janë me mua dhe kujtim i atyre që ishin para meje. Por shumica e tyre nuk e dinë të vërtetën, ndaj shmangen.

أَمْ اتَّخَذُوا مِنْ دُونِهِ إِلَهًا ۗ قُلْ هَاتُوا بُرْهَانَكُمْ ۗ هَذَا ذِكْرٌ مَنْ مَعِيَ وَذِكْرٌ مَنْ قَبْلِي ۗ بَلْ أَكْثَرُهُمْ لَا يَعْلَمُونَ الْحَقَّ فَهُمْ مُّعْرِضُونَ ﴿٢٥﴾

26. Përpara teje nuk dërguam asnjë të dërguar, përveçse i shpallëm që nuk ka të adhureshëm tjetër përveç Meje, andaj, Mua Më adhuroni.

وَمَا أَرْسَلْنَا مِنْ قَبْلِكَ مِنْ رَسُولٍ إِلَّا نُوحِيَ إِلَيْهِ أَنَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنَا فَاعْبُدُونِ ﴿٢٦﴾

27. Dhe ata thanë: “I Gjithëmëshirshmi ka marrë bir”. I Shenjtë është Ai! Përkundrazi, ata (që të tjerët i quajnë bij të Tij) janë robër të ndershëm.

وَقَالُوا اتَّخَذَ الرَّحْمَنُ وَلَدًا سُبْحٰنَهُ ۗ بَلْ عِبَادٌ مُّكْرَمُونَ ﴿٢٧﴾

28. Ata nuk e parakalojnë Atë në fjalë dhe punojnë vetëm me urdhrin e Tij.

لَا يَسْبِقُونَهُ بِالْقَوْلِ وَهُمْ بِأَمْرِهِ يَعْمَلُونَ ﴿٢٨﴾

29. Ai di gjithçka që është para tyre dhe gjithçka që është pas tyre dhe ata nuk ndërmjetësojnë, përveçse për atë të cilin Ai e pëlqen. Ata nga frika ndaj Tij, janë të ndrojtur.

يَعْلَمُ مَا بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَمَا خَلْفَهُمْ وَلَا يُشْفَعُونَ إِلَّا لِمَنْ أَرَادَ وَهُمْ مِنْ حَسْبَتِهِ ۗ مُّشْفِقُونَ ﴿٢٩﴾

30. E kushdo prej tyre që thotë: “Unë jam Zot përveç Atij”, Ne atë e ndëshkojmë me xhehenem. Ne kështu i ndëshkojmë të padrejtët.

وَمَنْ يَقُلْ مِنْهُمْ إِنِّي إِلَهٌ مِنْ دُونِهِ ۗ فَذٰلِكَ نَجْزِيهِ جَهَنَّمَ ۗ كَذٰلِكَ نَجْزِي الظّٰلِمِيْنَ ﴿٣٠﴾

31. Ata që mohuan a nuk e kanë parë se qiejt dhe toka kanë qenë të mbyllura dhe Ne i hapëm ato dhe çdo gjë të gjallë krijiam përmes ujit?! A nuk besojnë?!<sup>2</sup>

أَوَلَمْ يَرَ الَّذِينَ كَفَرُوا أَنَّ السَّمَوَاتِ  
وَالْأَرْضَ كَانَتَا رَتْقًا فَفَتَقْنَاهُمَا ۖ وَجَعَلْنَا  
مِنَ الْمَاءِ كُلَّ شَيْءٍ حَيٍّ أَفَلَا يُؤْمِنُونَ ﴿٣١﴾

32. Dhe krijiam malet në tokë, që ato t'u sigurojnë atyre ushqimin. Në to bëmë edhe rrugë të gjera, që të udhëzohen.

وَجَعَلْنَا فِي الْأَرْضِ رَوَاسِيَ أَنْ  
تَمِيدَ بِهِمْ ۖ وَجَعَلْنَا فِيهَا فِجَاجًا سُبُلًا  
لَّعَلَّهُمْ يَهْتَدُونَ ﴿٣٢﴾

33. Dhe qiellin bëmë si çati të mbrojtur, kurse ata shmangen nga shenjat e tij.

وَجَعَلْنَا السَّمَاءَ سَقْفًا مَحْفُوظًا ۗ وَهُمْ  
عَنِ آيَاتِهَا مُعْرِضُونَ ﴿٣٣﴾

34. Dhe është Ai që krijoi natën dhe ditën, diellin dhe hënën. Secili noton në një orbitë (të vet).

وَهُوَ الَّذِي خَلَقَ اللَّيْلَ وَالنَّهَارَ وَالشَّمْسَ  
وَالْقَمَرَ ۗ كُلٌّ فِي فَلَكٍ يَسْبَحُونَ ﴿٣٤﴾

35. Dhe asnjë njeriu nuk i kemi dhënë përjetësinë përpara teje. Nëse ti vdes, si mundet që ata të jetojnë përgjithmonë?!<sup>3</sup>

وَمَا جَعَلْنَا لِبَشَرٍ مِّن قَبْلِكَ الْخُلْدَ ۗ أَفَأَبْرِ  
مِتَّ فَهَمَّ الْخُلْدُونَ ﴿٣٥﴾

2. Më shumë se 14 shekuj më parë, Kurani i Shenjtë zbuloi që universi është duke u zgjeruar pandërprerë (51:48), gjë që do të bëhej një fakt shkencor vetëm në vitet 1920. Zbulimi se universi vazhdimisht po zgjerohet është me rëndësi të madhe për shkencëtarët, sepse ndihmon për të kuptuar më saktësisht se si universi u krijua fillimisht. Gjithashtu, shpjegon qartazi procesin fazë pas faze të krijimit, në atë mënyrë që përputhet me konceptin e Big Bangut. Kurani shkon më tej dhe përshkruan gjithë ciklin e fillimit dhe të fundit të universit, madje edhe të rikthimit të tij përsëri në një fillim të ngjashëm si më parë. Hapi i parë i krijimit siç përmendet në Kuran, ngjan shumë me atë që quhet Big Bang, të cilin Kurani e përshkruan këtu. Në këtë ajet fjalët *retkan* (masë e mbyllur) dhe *fetakna* (Ne hapëm), mbajnë mesazhin qendror të të gjithë ajetit. Fjalorët autentikë të gjuhës arabe japin dy kuptime të fjalës *retkan*, që kanë rëndësi të madhe për temën në diskutim. Një kuptim i saj është *të mbledhurit e diçkaje dhe pastaj shkrirja në një entitet të vetëm* (përmbledhur nga fjalori Lane) dhe kuptimi i dytë është *errësirë totale* (Lisan el-Arab). Të dyja këto kuptime janë të zbatueshme dhe japin domethënie thelbësore. Të marra së bashku, ato tregojnë pamje të saktë të veçorisë së një vrime të zezë. Lexoni edhe 21:105.

3. Në këtë ajet Zoti i thotë Profetit Muhammed<sup>savs</sup> – Ne nuk i kemi dhënë përjetësinë asnjë njeriu përpara teje, andaj, për sa kohë që edhe ti do të vdesësh, si mund të jenë të gjallë të tjerët?! Thelbi i ajetit është që të gjithë njerëzit, pa përjashtim, i nënshtrohen një ligji të vetëm

36. Çdo shpirt shijon vdekjen. Ne do t'ju sprovovjmë fort me të keqen dhe të mirën dhe te Ne do të ktheheni.

كُلُّ نَفْسٍ ذَائِقَةُ الْمَوْتِ ۗ وَنَبَلُّوكُمُ بِالْأَشْرِّ  
وَالْخَيْرِ فِتْنَةً ۗ وَإِنَّا تُرْجِعُونَ ﴿٣٦﴾

37. Ata që mohuan, sa herë që të shohin ty, të marrin për tallje: “A ky qenka ai që flet për zotat tuaj?!” Ndërkohë pikërisht këta e mohojnë përmendjen e të Gjithëmëshirshmit.

وَإِذَا رَأَى الَّذِينَ كَفَرُوا إِنْ يَتَّخِذُونَكَ  
إِلَّا هُزُوًا ۗ أَهَذَا الَّذِي يَذَّكَّرُ إِلَيْكُمْ ۗ  
وَهُمْ يَذَّكَّرِ الرَّحْمَنِ هُمْ كَفِرُونَ ﴿٣٧﴾

38. Njeriu është krijuar i ngutshëm. Unë patjetër do t'ju tregoj shenjat e Mia, andaj, mos M'i kërkoni me ngut.

خَلَقَ الْإِنْسَانَ مِنْ عَلَجٍ ۗ سَآوِرِيكُمْ أُنثَىٰ  
فَلَا تَسْتَعْجِلُونِ ﴿٣٨﴾

39. Ata pyesin: “Kur do të përbushet ky premtim, nëse thoni të vërtetën?”

وَ يَقُولُونَ مَتَىٰ هَذَا الْوَعْدُ إِنْ كُنْتُمْ  
صَادِقِينَ ﴿٣٩﴾

40. Sikur ta dinë ata që mohuan (që asgjë nuk mund të bëjnë) në kohën kur nuk mund ta ndalin zjarrin as nga fytyrat e tyre e as nga shpinat e tyre dhe as nuk do të ndihmohen!

لَوْ يَعْلَمُ الَّذِينَ كَفَرُوا حِينَ لَا يَكْفُرُونَ  
عَنْ وُجُوهِهِمُ النَّارَ وَلَا عَنْ ظُهُورِهِمْ  
وَلَا هُمْ يُنصَرُونَ ﴿٤٠﴾

41. Madje, ai (çast) do t'u vijë befas dhe do t'i shtangë, atëherë ata as nuk mund ta largojnë atë dhe atyre as nuk do t'u jepet kohë.

بَلْ تَأْتِيهِمْ بَغْتَةً فَتَبْهَتُهُمْ فَلَا يَسْتَطِيعُونَ  
رَدَّهَا وَلَا هُمْ يُنصَرُونَ ﴿٤١﴾

42. Kanë përqeshur me të Dërguarit edhe para teje. Atëherë ata që i përqeshën i zuri e njëjta gjë të cilën e përqeshnin.

وَلَقَدْ اسْتَهْزَأَ بِرُسُلٍ مِنْ قَبْلِكَ فَحَاقَ  
بِالَّذِينَ سَخِرُوا مِنْهُمْ مَا كَانُوا بِهِ  
يَسْتَهْزِءُونَ ﴿٤٢﴾

të Allahut, saqë askush nuk i ka shpëtuar dot vdekjes as në të kaluarën dhe nuk do t'i shpëtojë dikush as në të ardhmen. Fjala *khuld* që është përdorur këtu, sipas fjalorit, do të thotë *gjendje e pandryshuar*, sepse ndryshimi lajmëron edhe rënien e më pas edhe vdekjen. Pra, ky ajet e mohon idenë se ndokush prej krijesave të Zotit të mos pësojë ndryshime që shkaktohen nga koha etj., ndryshime të cilat, patjetër e çojnë drejt pleqërisë e më pas drejt vdekjes. Isai biri i Merjemes nuk mund të përjashtohet nga ky ligj i Zotit, për sa kohë që edhe Profeti Muhammed<sup>savs</sup> iu nënshtrua këtij ligji. Nëse ka ndërruar jetë Profeti Muhammed<sup>savs</sup>, duhet të ketë ndërruar jetë edhe Hazret Isai<sup>as</sup>. Lexoni edhe 21:9.

43. Thuaj: “Kush ju shpëton gjatë natës dhe gjatë ditës prej të Gjithëmëshirshmit?!” Madje, i shmangen përmendjes së Zotit të tyre!

44. A kanë të adhurueshëm që do t'i mbrojnë ata nga Ne?! Ata as vetveten nuk e ndihmojnë dot dhe nuk do të ndihmohen as nga Ne.

45. Në të vërtetë, Ne i furnizuam me begati ata dhe baballarët e tyre, derisa (kështu) iu zgjat jeta. A nuk shohin që Ne përnjëmend po (ua) shkurtojmë tokën nga anët e saj?! Atëherë, a do të fitojnë ata?!

46. Thuaj: Unë vetëm ju alarmoj përmes shpalljes. Të shurdhrit nuk e dëgjojnë thirrjen kur alarmohen.

47. E nëse i prek qoftë një erë e lehtë e ndëshkimit të Zotit tënd, patjetër do të thonë: “Mjerë ne! Vërtet kemi qenë keqberës!”

48. Ne do të vendosim peshoret e drejtësisë Ditën e Kiametit, atëherë asnjë shpirti nuk do t'i bëhet padrejtësi aspak. Edhe sikur të ketë diçka që peshon sa një kokërr sinapi, Ne do ta sjellim atë. Dhe Ne jemi të Mjaftueshëm për të kërkuar llogari.

49. Ne i dhamë Musait dhe Harunit dalluesin, një dritë dhe një këshillë për të druajturit;

قُلْ مَنْ يَكْفُرْكُمْ بِاللَّيْلِ وَالنَّهَارِ مِنَ الرَّحْمَنِ ۗ بَلْ هُمْ عَنْ ذِكْرِ رَبِّهِمْ مُعْرِضُونَ ﴿٤٣﴾

أَمْ لَهُمُ إِلَهَةٌ تَمْنَعُهُمْ مِّنْ دُونِنَا ۚ لَا يَسْتَطِيعُونَ نَصْرَ أَنفُسِهِمْ وَلَا هُمْ مِنَّا يُصْحَبُونَ ﴿٤٤﴾

بَلْ مَتَّعْنَا هَؤُلَاءِ وَآبَاءَهُمْ حَتَّى طَالَ عَلَيْهِمُ الْعُمُرُ ۗ أَفَلَا يَرَوْنَ أَنَّا نَأْتِي الْأَرْضَ نَنْقُصُهَا مِنْ أَطْرَافِهَا ۗ أَفَهُمُ الْغَالِبُونَ ﴿٤٥﴾

قُلْ إِنَّمَا أُنذِرُكُمْ بِالْوَحْيِ ۗ وَلَا يَسْمَعُ الصُّمُّ الدُّعَاءَ إِذَا مَا يُنذَرُونَ ﴿٤٦﴾

وَلَئِن مَّسَّتْهُمْ نَفْحَةٌ مِّنْ عَذَابِ رَبِّكَ لَيَقُولُنَّ يُوَيْلَنَا إِنَّا كُنَّا ظَالِمِينَ ﴿٤٧﴾

وَنَضَعُ الْمَوَازِينَ الْقِسْطَ لِيَوْمِ الْقِيَامَةِ ۗ فَلَا تُظْلَمُ نَفْسٌ شَيْئًا ۗ وَإِنْ كَانَ مِثْقَالَ حَبَّةٍ مِّنْ خَرْدَلٍ أَتَيْنَا بِهَا ۗ وَكَفَى بِنَا حُسَيْنًا ﴿٤٨﴾

وَلَقَدْ آتَيْنَا مُوسَى وَهَارُونَ الْفُرْقَانَ ۗ وَضِيَاءً وَذِكْرًا لِّلْمُتَّقِينَ ﴿٤٩﴾

50. (për) ata që i frikësohen Zotit të tyre edhe kur janë vetëm, dhe (që) i tremben Orës.

الَّذِينَ يَخْشَوْنَ رَبَّهُم بِالْغَيْبِ وَهُمْ مِنْ  
السَّاعَةِ مُشْفِقُونَ ﴿٥٠﴾

51. Dhe kjo është këshillë e bekuar që Ne zbritëm. Ju këtë po e mohoni?!

وَهَذَا ذِكْرٌ مُّبْرَكٌ أَنْزَلْنَاهُ أَفَأَنْتُمْ لَهُ  
اللَّهِ مُنْكَرُونَ ﴿٥١﴾

52. Dhe Ibrahimit i dhamë më parë pjekurinë dhe Ne e njihnim atë.

وَلَقَدْ آتَيْنَا إِبْرَاهِيمَ رُشْدَهُ مِنْ قَبْلُ  
وَكُنَّا بِهِ عَالِمِينَ ﴿٥٢﴾

53. Kur ai i tha babait dhe popullit të tij: “Çfarë janë këta idhuj, të cilëve ju u rrini të përkushtuar?!”

إِذْ قَالَ لِأَبِيهِ وَقَوْمِهِ مَا هَذِهِ التَّمَاثِيلُ  
الَّتِي أَنْتُمْ لَهَا عَاكِفُونَ ﴿٥٣﴾

54. Ata thanë: “Ne gjetëm etërit tanë duke i adhuruar këta.”

قَالُوا وَجَدْنَا آبَاءَنَا لَهَا عَابِدِينَ ﴿٥٤﴾

55. (Ibrahimi) tha: “Njëmend, ju dhe etërit tuaj keni qenë qartazi në humbje.”

قَالَ لَقَدْ كُنْتُمْ أَنْتُمْ وَآبَاؤُكُمْ فِي ضَلَالٍ  
مُبِينٍ ﴿٥٥﴾

56. Ata thanë: “A ke ardhur ti me të vërtetën apo bën lojë me ne?!”

قَالُوا أَجِئْتَنَا بِالْحَقِّ أَمْ أَنْتَ مِنَ اللَّاعِبِينَ ﴿٥٦﴾

57. Ai tha: “Jo! E vërteta është se Zoti juaj është Zoti i qiejve dhe i tokës që i krijoi (edhe) këta (idhuj) dhe për këtë unë jam dëshmitar.

قَالَ بَلْ رَبُّكُمْ رَبُّ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ  
الَّذِي فَطَرَهُنَّ ۗ وَأَنَا عَلَىٰ ذِكْمِكُمْ مِنَ  
الشَّاهِدِينَ ﴿٥٧﴾

58. Për Allahun! Unë përnjëmend do të bëj një plan kundër idhujve tuaj, pasi ju të ktheheni mbrapsht.”

وَ تَاللَّهِ لَأَكِيدَنَّ أَصْنَامَكُمْ بَعْدَ أَنْ  
تَوَلَّوْا مُدْبِرِينَ ﴿٥٨﴾

59. Atëherë ai i bëri copë-copë, me përjashtim të të madhit prej tyre, që ata t'i riktheheshin.

فَجَعَلَهُمْ جُودًا إِلَّا كَبِيرًا لَهُمْ لَعَلَّهُمْ إِلَيْهِ  
يَرْجِعُونَ ﴿٥٩﴾



60. (Ata) thanë: “Kush e bëri këtë me zotat tanë?! Ai pa dyshim është keqbërës!”

قَالُوا مَنْ فَعَلَ هَذَا بِالْهَيْتَا إِنَّهُ لَمِنَ  
الظَّالِمِينَ ﴿١٠﴾

61. Thanë: “Kemi dëgjuar për një djalë që i përmendte; e quajne Ibrahim.”

قَالُوا سَمِعْنَا فَتَى يَذُكُرُهُمْ يُقَالُ لَهُ  
إِبْرَاهِيمُ ﴿١١﴾

62. Thanë: “Atëherë silleni atë përpara syve të njerëzve, që ta shohin.”

قَالُوا فَأْتُوا بِهِ عَلَى أَعْيُنِ النَّاسِ لَعَلَّهُمْ  
يَشْهَدُونَ ﴿١٢﴾

63. Thanë: “A ti e ke bërë këtë me zotat tanë, o Ibrahim?”

قَالُوا ءَأَنْتَ فَعَلْتَ هَذَا بِالْهَيْتَا  
يَا إِبْرَاهِيمُ ﴿١٣﴾

64. (Ibrahimi) tha: “Jo, e bëri ky, i madhi i tyre! Pyetini ata nëse flasin dot.”<sup>4</sup>

قَالَ بَلْ فَعَلَهُ كَبِيرُهُمْ هَذَا فَسَلُّوهُمْ  
إِنْ كَانُوا يَبْطِقُونَ ﴿١٤﴾

65. Atëherë ata u kthyen te shokët e tyre dhe i thanë (njëri-tjetrit): “Njëmend, ju jeni të padrejtë!”

فَرَجَعُوا إِلَىٰ أَنفُسِهِمْ فَقَالُوا إِنَّكُمْ أَنْتُمْ  
الظَّالِمُونَ ﴿١٥﴾

66. Më pas u janë ulur kokat (dhe thanë): “Ti e di që këta nuk flasin dot.”

ثُمَّ نَكِسُوا عَلَىٰ رُءُوسِهِمْ لَقَدْ عَلِمْتَ مَا  
هَؤُلَاءِ يَبْطِقُونَ ﴿١٦﴾

67. (Ibrahimi) tha: “A po adhurakeni diçka tjetër përveç Allahut, që as nuk ju sjell dobi ndopak, e as nuk ju sjell dot dëm?!”

قَالَ أَفَعَبُدُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ مَا لَا  
يَنْفَعُكُمْ شَيْئًا وَلَا يَضُرُّكُمْ ﴿١٧﴾

4. Në lidhje me këtë ajet thuhet që duhet të bësh pauzë pas fjalëve “*bel fe’alehu*”, që të përkthehet se “dikush e ka bërë këtë”, sepse përndryshe sipas tyre, Hazret Ibrahimi<sup>as</sup> rezulton të ketë gënjeshtër, *ma’adhallah!* Por kjo nuk duket e nevojshme, sepse vetë Hazret Ibrahimi<sup>as</sup> ua kishte thënë më parë se do të bënte diçka kundër idhujve të tyre. Prandaj, pohimi i tij nuk quhet gënjeshtër. Përkundrazi, kjo është një mënyrë replike, pra duke paraqitur një gjë krejt të pamundur si diçka të mundshme, metodë të cilën Hazret Ibrahimi<sup>as</sup> e zotëronte mirë me ndihmën e Zotit. Së dyti, asnjëri nga kundërshtarët e tij nuk besoi se idhulli i madh i kishte rrëzuar idhujt e tjerë, madje e quajtën të pamundur. Pra, kështu Hazret Ibrahimi<sup>as</sup> e provoi se besimi i tyre ishte i remë dhe se idhujt nuk kishin asnjë fuqi.

68. Vaj për ju dhe për atë që e adhuroni në vend të Allahut! A nuk kuptoni?!”

69. Thanë: “Digjeni këtë dhe ndihmijini zotat tuaj, në qoftë se doni të veproni.”

70. Ne thamë: “O zjarr! Bëhu i ftohtë dhe i sigurt për Ibrahimin!”<sup>5</sup>

71. Ata vendosën t'i bënin kurth (Ibrahimit), atëherë Ne i çuam ata në humbjen më të thellë.

72. Ne e shpëtuan atë dhe Lutin drejt një toke, të cilën e bekuam për botët.

73. Dhe atij i dhuruam Is'hakun, dhe Jakubin si nip. Të gjithë i bëmë të dëlirë.

74. I bëmë imamë që udhëzonin me urdhrin Tonë dhe atyre u shpallëm të bënin mirësi, të falnin namazin dhe të jepnin zekatin. Ata Na adhuronin Ne.

75. Dhe Lutit i dhamë urtësi dhe dije dhe e shpëtuan nga fshati që bënte punë të ndyra. Njëmend, ata ishin një popull keqbërës, të ligj.

76. Ne e futëm (Lutin) në mëshirën Tonë. Sigurisht, ai ishte ndër të dëlirët.

أَفِ لَكُمْ وَلِمَا تَعْبُدُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ  
أَفَلَا تَعْقِلُونَ ﴿٦٨﴾

قَالُوا حَرِّقُوهُ وَانصُرُوا آلِهَتَكُمْ إِنْ كُنْتُمْ  
فَاعِلِينَ ﴿٦٩﴾

قُلْنَا يَا نَارُ كُونِي بَرْدًا وَسَلَامًا عَلَىٰ إِبْرَاهِيمَ ﴿٧٠﴾

وَأَرَادُوا بِهِ كَيْدًا فَجَعَلْنَاهُمُ الْأَخْسَرِينَ ﴿٧١﴾

وَنَجَّيْنَاهُ وَ لُوطًا إِلَى الْأَرْضِ الَّتِي بَرَكْنَا  
فِيهَا لِلْعَالَمِينَ ﴿٧٢﴾

وَ وَهَبْنَا لَهُ إِسْحَاقَ وَيَعْقُوبَ نَافِلَةً  
وَ كَلًّا جَعَلْنَا صَالِحِينَ ﴿٧٣﴾

وَ جَعَلْنَاهُمْ أَيْمَةً يَهْتَدُونَ يَا مَرْيَمُ مَا أُوحِيَ  
إِلَيْهِمْ فَعَلِ الْخَيْرَاتِ وَإِقَامَ الصَّلَاةِ  
وَ آتَاءَ الزَّكَاةِ وَ كَانُوا لَنَا عِبْدِينَ ﴿٧٤﴾

وَ لُوطًا آتَيْنَاهُ حُكْمًا وَ عِلْمًا وَ نَجَّيْنَاهُ مِنَ  
الْقَرْيَةِ الَّتِي كَانَتْ تَعْمَلُ الْخَبِيثَ إِتَاهُمْ  
كَانُوا قَوْمًا سَوَاءً فَسِقِينَ ﴿٧٥﴾

﴿٧٦﴾ وَ ادْخَلْنَاهُ فِي رَحْمَتِنَا إِنَّهُ مِنَ الصَّالِحِينَ ﴿٧٧﴾

5. Fjala zjarr në këtë ajet i referohet edhe zjarrit fizik, edhe zjarrit të kundërshtimit.

77. Dhe (përmende edhe) Nuhun, kur ai thirri përpara (këtyre), atëherë Ne iu përgjigjëm dhe e shpëtuan atë dhe familjen e tij nga ankthi i madh.

وَنُوحًا إِذْ نَادَى مِنْ قَبْلٍ فَاسْتَجَبْنَا لَهُ  
فَنجَّيْنَاهُ وَأَهْلَهُ مِنَ الْكَرْبِ الْعَظِيمِ ﴿٧٧﴾

78. Dhe e ndihmuam kundër popullit, që i quajtën gënjeshtër shenjat Tona. Njëmend, ata ishin një popull keqbërës, dhe Ne i fundosëm ata krejt.

وَنَصَرْنَاهُ مِنَ الْقَوْمِ الَّذِينَ كَذَبُوا بِالآيَاتِ  
إِنَّمَا كَانُوا قَوْمًا سَوِيًّا فَاغْرَقْنَاهُمْ  
أَجْمَعِينَ ﴿٧٨﴾

79. Edhe Davudin dhe Sulejmanin (përmendi), kur ata po gjykonin për arën; kur dhitë dhe delet e njerëzve e kullotën atë gjatë natës. Ne ishim Dëshmitarë të gjykimit të tyre.

وَدَاوُدَ وَسُلَيْمَانَ إِذْ يَحْكُمَانِ فِي الْحَرْثِ  
إِذْ نَفَسَتْ فِيهِ غَمَمُ الْقَوْمِ وَكُنَّا لِحَكْمِهِمْ  
شَاهِدِينَ ﴿٧٩﴾

80. Atëherë e bëmë Sulejmanin ta kuptonte drejt (çështjen) dhe secilit i dhamë urtësi dhe dije. Dhe Davudit i nënshtroam malet (që) lëvdonin (Zotin) bashkë me të, po ashtu edhe zogjtë. Dhe ishim Ne që e bënim këtë.<sup>6</sup>

فَفَهَّمْنَاهَا سُلَيْمَانَ ۚ وَكَلَّمْنَا آتِينَ حُكْمًا  
وَعِلْمًا ۗ وَ سَحَرْنَا مَعَ دَاوُدَ الْجِبَالَ  
يُسَبِّحْنَ وَالطَّيْرَ ۗ وَكُنَّا فَاعِلِينَ ﴿٨٠﴾

81. Dhe për ju atij i mësuam punimin e parzmoreve, që ato t'ju mbrojnë nga luftërat tuaja. Pra, a jeni mirënjohës ju?

وَعَلَّمْنَاهُ صِنْعَةَ لُبُوسٍ لَكُمْ لِيُخَصِّنْكُمْ  
مِّنْ بَأْسِكُمْ ۚ فَهَلْ أَنْتُمْ شَاكِرُونَ ﴿٨١﴾

6. Nënshtrimi i maleve nuk do të thotë se malet t'i përulëshin Davudit<sup>as</sup>. Për popullin e Muhammedit<sup>savs</sup>, Kurani pohon: "Zoti nënshtroi për ju atë që është në qiej dhe atë që është në tokë, gjithçka prej Tij" (45:14). Kështu, nënshtrimi i maleve do të thotë se Zoti i nënshtroi popujt e maleve për Hazret Davudin<sup>as</sup>. Po ashtu, përmendet ushtria e zogjve në ushtrinë e Hazret Sulejmanit<sup>as</sup>. Edhe kjo është metaforë, që mund të ketë dy kuptime: 1) njerëzit që kanë aftësi "të fluturojnë" shpirtërisht dhe 2) kalorësit e shpejtë që, sikur zogjtë, udhëtonin me shpejtësi nga një vend në tjetrin. Edhe ushtria e kalorësve të Hazret Sulejmanit<sup>as</sup> është cilësuar si ushtria e zogjve. Lexoni edhe 34:12-13.

82. Dhe Sulejmanit (i nënshtruar) erën e fortë, e cila lëvizte me urdhrin e tij drejt tokës që Ne e bekuam. Dhe ishim Ne të Diturit për çdo gjë.<sup>7</sup>

وَلَسَلِيمُنَ الرَّيْحِ عَاصِفَةً تَجْرِي بِأَمْرِهِ  
إِلَى الْأَرْضِ الَّتِي بَرَكْنَا فِيهَا وَكُنَّا بِكُلِّ  
شَيْءٍ عَلِيمِينَ ﴿٧٧﴾

83. Dhe prej shejtanëve ishin edhe nga ata që zhyteshin për të dhe bënëin edhe punë të tjera përveç kësaj. Dhe ishim Ne që i mbronim.<sup>8</sup>

وَمِنَ الشَّيْطَانِ مَنْ يُعْوِضُونَ لَهُ وَيَعْمَلُونَ  
عَمَلًا دُونَ ذَلِكَ وَكُنَّا لَهُمْ حَافِظِينَ ﴿٧٨﴾

84. Dhe (përmende edhe) Ejubin, kur ai e thirri Zotin e tij: “Mua më ka prekur dhimbja, Tije më i Mëshirshmi nga të gjithë mëshiruesit!”

وَإِيُوبَ إِذْ نَادَى رَبَّهُ أَنِّي مَسَّنِيَ الضُّرُّ  
وَأَنْتَ أَرْحَمُ الرَّحِيمِينَ ﴿٨١﴾

85. Atëherë Ne ia pranuar lutjen, e larguam dhimbjen që ai kishte dhe i dhamë familjen e tij dhe, bashkë me ta, edhe të tjerë si ata; (kjo ishte) si mëshirë prej Nesh dhe si këshillë për adhuruesit.

فَاسْتَجَبْنَا لَهُ فَكَشَفْنَا مَا بِهِ مِنْ ضُرٍّ وَأَتَيْنَاهُ  
أَهْلَهُ وَمِثْلَهُم مَّعَهُمْ رَحْمَةً مِنْ عِنْدِنَا  
وَذِكْرًا لِلْعَبِيدِينَ ﴿٨٢﴾

86. Dhe (përmendi edhe) Ismailin, Idrisin dhe Dhul-kiflin. Të gjithë ishin durimtarë.<sup>9</sup>

وَإِسْمَاعِيلَ وَإِدْرِيسَ وَذَا الْكِفْلِ كُلٌّ  
مِنَ الصَّابِرِينَ ﴿٨٣﴾

87. Ne i morëm në mëshirën Tonë. Pa dyshim, ata ishin të dëlirë.

وَأَدْخَلْنَاهُمْ فِي رَحْمَتِنَا إِنَّهُمْ مِنَ  
الصَّالِحِينَ ﴿٨٤﴾

7. Nënshtrimi i erërave për Hazret Sulejmanin<sup>as</sup> do të thotë që në zonat bregdetare të Palestinës erërat ndryshonin drejtimin pas çdo muaji dhe anijet e Hazret Sulejmanit lundronin me ndihmën e tyre.

8. Fjala “shejātīn” (shejtan në shumës) nuk do të thotë shejtanë të krijuar prej zjarri, se përndryshe ata do të shuheshin sapo të zhyteshin në det, por do të thotë popuj rebelë, që i nënshtrori Hazret Sulejmani<sup>as</sup> dhe prej tyre disa ishin edhe zhytës. Lexoni edhe 2:15; 2:37.

9. Ajeti i përmend bashkë Ismailin<sup>as</sup>, Idrisin<sup>as</sup> dhe Dhul-kiflin<sup>as</sup>, të cilët nuk kanë qenë bashkëkohës. Arsyja e përmendjes së tyre në një ajet të vetëm mund të jetë sepse të tre ishin Profetë që nuk sollën shariat dhe se që të tre përjetuan vështirësi të mëdha në jetën e tyre duke i duruar në mënyrë shembullore. Në vijim, përmendet edhe Junusi<sup>as</sup>, njeriu i peshkut, dhe edhe ai u bë shembull i durimit.

88. (Përmende) edhe atë të peshkut, kur iku i zemëruar dhe mendoi që nuk do ta kapnim. Atëherë nga errësirat ai thirri: “Nuk ka të adhureshëm tjetër përveç Teje! Ti je i Shenjtë, e unë isha i padrejtë!”<sup>10</sup>

وَ ذَا التُّونِ إِذْ ذَهَبَ مُخَاضًا فَظَنَّ أَنْ  
لَنْ نَقْدِرَ عَلَيْهِ فَنَادَى فِي الظُّلُمَاتِ أَنْ لَا  
إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ سُبْحَانَكَ إِنِّي كُنْتُ مِنَ  
الظَّالِمِينَ ﴿٨٨﴾

89. Atëherë Ne ia pranuar lutjen dhe e shpëtuan nga brenga. Kështu i shpëtojmë besimtarët.

فَاسْتَجَبْنَا لَهُ وَنَجَّيْنَاهُ مِنَ الْعَمِّ ط وَكَذَلِكَ  
نُنَجِّي الْمُؤْمِنِينَ ﴿٨٩﴾

90. (Përmende) edhe Zekerijanë, kur ai e thirri Zotin e tij: “O Zoti im! Mos më lërë vetëm dhe Ti je më i miri prej trashëguesve!”

وَ زَكَرِيَّا إِذْ نَادَى رَبَّهُ رَبِّ لَا تَذَرْنِي فَرْدًا  
وَأَنْتَ خَيْرُ الْوَارِثِينَ ﴿٩٠﴾

91. Ne ia dëgjuam lutjen, atij i dhuruam Jahjain dhe ia përmirësuar gruan. Sigurisht, ata nxitoreshin në mirësi dhe Na thërrisnin me ëndje e frikë dhe Neve na përuleshin me përgjërime.

فَاسْتَجَبْنَا لَهُ وَوَهَبْنَا لَهُ يَحْيَىٰ وَاصْلَحْنَا  
لَهُ زَوْجَهُ ط إِنَّهُمْ كَانُوا يُسْرِعُونَ فِي  
الْخَيْرَاتِ وَيَدْعُونَنَا رَغَبًا وَرَهَبًا ط وَكَانُوا  
لَنَا خَشِيعِينَ ﴿٩١﴾

92. Dhe (përmende) atë grua që ruajtji nderin e vet, atëherë Ne frymë në të diçka nga Shpirti Ynë dhe atë dhe të birin e saj i bëmë shenjë për botët.

وَأَتَيْنَاهُ إِحْصَانًا فَرَجَحْنَا فَفَاحْنَا فِيهَا مِنْ  
رُوحِنَا وَجَعَلْنَاهَا آيَةً لِلْعَالَمِينَ ﴿٩٢﴾

93. Pikërisht ky është *umeti* juaj, një *umet*, dhe Unë jam Zoti juaj, andaj, Mua Më adhuroni.

إِنَّ هُدَىٰ أُمَّتِكُمْ أُمَّةً وَاحِدَةً ط وَأَنَا رَبُّكُمْ  
فَاعْبُدُونِ ﴿٩٣﴾

10. Fjala është për *Hazret Junusin*<sup>as</sup>, i cili kur pa që profecia e tij për ndëshkimin nuk u përmbush, udhëtoi i zemëruar drejt detit, sepse ai nuk dinte se një profeci e tillë mund të evitohej nga përmbushja, në rast se njerëzit për të cilët është bërë profecia, pendohen dhe i kërkojnë falje Zotit me përgjërime. Në det *Hazret Junusin*<sup>as</sup> e kapërdiu të gjallë një balenë dhe të gjallë e nxori. Në këtë kohë errësire, ishte kjo pikërisht lutja që buroi nga zemra e tij, që përmendet në këtë ajet.

94. Dhe (më vonë) ata e përçanë çështjen e tyre. Te Ne do të kthehen të gjithë.

وَتَقَطَّعُوا أَمْرَهُمْ بَيْنَهُمْ ۗ كُلٌّ إِلَيْنَا  
يَرْجِعُونَ ﴿١٤﴾

95. Kushdo që bën të mira duke qenë besimtar, nuk do t'i mohohet përpjekja. Sigurisht, Ne do ta shënojmë për të.

فَمَنْ يَعْمَلْ مِنَ الصَّالِحَاتِ وَهُوَ مُؤْمِنٌ فَلَا  
كُفْرَانَ لِسَعْيِهِ ۗ وَإِنَّا لَهُ كَاتِبُونَ ﴿١٥﴾

96. Për një vendbanim që Ne e kemi shkatërruar, është e ndaluar që (banorët e tij) të kthehen sërish.<sup>11</sup>

وَحَرَّمَ عَلَىٰ قَرْيَةٍ أَهْلَكْنَاهَا أَنَّهُمْ  
لَا يَرْجِعُونَ ﴿١٦﴾

97. (Kështu do të vijojë) edhe kur<sup>12</sup> të lirohen Jexhuxhët e Mexhuxhët dhe këta do të vijnë duke vrapuar nga çdo lartësi.<sup>13</sup>

حَتَّىٰ إِذَا فُتِحَتْ يَأْجُوجُ وَمَأْجُوجُ وَهُمْ  
مِّن كُلِّ حَدَبٍ يَنْسِلُونَ ﴿١٧﴾

11. Ky ajet tregon se nuk është në praktikën e Zotit të ringjallë që në këtë botë dikë që ka vdekur. Edhe në hadith përmendet që kur *Hazret Xhabiri*<sup>ra</sup> ishte i pikëlluar për shkak të vdekjes së babait të tij, Profeti Muhammed<sup>savs</sup> i tha: “A të njoftoj ty se çfarë gjeti babai yt kur e takoi Allahun?” “Patjetër që po, o i Dërguari i Allahut”, iu përgjigj Xhabiri<sup>ra</sup>. Profeti<sup>savs</sup> i tregoi: Allahu e pyeti babanë tënd – Më kërkoi çfarë të duash se do ta jap! – Më ringjall, o Zot, që të vritem edhe një herë në rrugën Tënde” i kërkoi babai yt. Por Allahu i Madhërishëm i tha – Jo, Unë e kam dekretuar që “ata (pasi të vdesin) nuk do të kthehen më!” (Tirmidhi, 3010). Në këtë hadith, i referohet pikërisht këtij ajeti të Kuranit. Prandaj, edhe ky ajet tregon se *Hazret Isai*<sup>as</sup> i ringjallte të vdekurit shpirtërorë dhe jo ata që kishin ndërruar jetë, njësoj siç thuhet edhe për Profetin Muhammed<sup>savs</sup> në 8:25.

12. Ajetet 96 – 97: Fjala *vendbanim* në ajetin 96, u referohet banorëve të vendbanimit. Pra, çdo popull që largohet nga kjo botë, nuk kthehet më këtu. Kurse në ajetin 97 është fjala *hatta*, që fjalë për fjalë do të thotë *gjersa*, nuk do të thotë se në kohën e Jexhuxhëve e të Mexhuxhëve, të gjithë popujt e vdekur do të rikthehen në këtë botë, por lidhëza *gjersa*, siç përdoret në gjuhën arabe në raste të caktuara, nënkupton që popujt e vdekur nuk do të kthehen as në kohën e Jexhuxhëve e të Mexhuxhëve. Në pamje të parë, ata do të tregojnë se gjoja i ringjallin të vdekurit, por të vdekurit e vërtetë kurrë nuk mund t'i ringjallin dot.

13. *Jexhuxhët e Mexhuxhët* dhe *Dexhalli* janë dy emra të ndryshëm, por përfaqësojnë një shoqëri të vetme, e cila në thelb e mohon Zotin, qoftë kategorikisht qoftë me veprimet e veta. Emri *dexhall* tregon gjendjen fetare të kësaj shoqërie, ndërsa *jexhuxh* e *mexhuxh* fuqinë materiale të saj, nëpërmjet së cilës, ajo do të mbizotërojë botën. Siç tregojnë edhe ajetet e tjera të Kuranit, feja e krishterë me dogmat e saj të gabuara, do të ishte mbizotëruese në botë. Kjo shoqëri do ta përdorte pikërisht krishterimin për t'u përhapur në botë. *Dexhall* fjalë për fjalë, do të thotë *mashtroes i madh, rrenacak, ai që e fsheh të vërtetën*. Në suren Merjem të Kuranit thuhet se gënjeshtria më e madhe është pikërisht shpifja e atij populli, i cili thotë se

98. Dhe do të afrohet premtimi i vërtetë, atëherë sytë e atyre që mohuan do të shtangen befaz: “Mjerë për ne! Kemi qenë të pavëmendshëm ndaj kësaj, madje kemi qenë keqbërës!”

وَاقْتَرَبَ الْوَعْدَ الْحَقِّ فَإِذَا هِيَ شَاخِصَةٌ  
أَبْصَارُ الَّذِينَ كَفَرُوا<sup>ط</sup> يُوَلِّتْنَا قَدَّ كُنَّا فِي  
عَقْلَةٍ مِّنْ هَذَا بَلْ كُنَّا ظَالِمِينَ<sup>٥٨</sup>

99. Njëmend, ju dhe ajo që adhuroni në vend të Allahut, jeni lëndë djegëse e xhehenemit. Atje do të zbrisni.

إِنَّكُمْ وَمَا تَعْبُدُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ حَصَبُ  
جَهَنَّمَ<sup>ط</sup> أَنْتُمْ لَهَا وَرَدُونَ<sup>٥٩</sup>

100. Këta po të ishin zota të vërtetë, kurrë nuk do të zbrisnin në të. Që të gjithë do të mbesin gjatë në të.

لَوْ كَانُوا هَوَالَاءِ إِلَهَةٍ مَّا وَرَدَوْهَا<sup>ط</sup> وَكُلَّ  
فِيهَا خُلِدُونَ<sup>٦٠</sup>

101. Në atë (xhehenem) do të kenë ofshama dhe atje nuk do të dëgjojnë dot (asgjë).

لَهُمْ فِيهَا زَفِيرٌ وَهُمْ فِيهَا لَا يَسْمَعُونَ<sup>٦١</sup>

102. Prej tij do të mbahen larg vetëm ata për të cilët kemi shkruar dekretin e mirësisë.

إِنَّ الَّذِينَ سَبَقَتْ لَهُمْ مِنَّا الْحُسْنَىٰ<sup>ل</sup> أُولَٰئِكَ  
عَنَّا مُبْعَدُونَ<sup>٦٢</sup>

103. Ata nuk do të dëgjojnë as fëshfërimën e tij, dhe në atë që shpirtrat e tyre e donin, ata do të jetojnë përgjithmonë.

لَا يَسْمَعُونَ حَسِيصَهَا<sup>ج</sup> وَهُمْ فِي مَا اشْتَهَتْ  
أَنفُسُهُمْ خُلِدُونَ<sup>٦٣</sup>

Zoti ka një djalë. Në këtë kuptim, emërtimi *dexhall* tregon aspektin fetar të vendeve që sot duan ta pushtojnë botën. Ndërsa fjalët *jexhuxh* e *mexhuxh* janë fjalë të prejardhura nga rrënja *exh-xhe* dhe *exhixhen*, që do thotë *flakë*, *afsh* i *zjarrit*, *djegje* e *fuqishme* (Lisan el-Arab, zëri ج جج). Ky emërtim tregon se këto vende do të përdornin shumë zjarrin apo energjinë. Makineritë e sotme funksionojnë prej ndonjë energjie, e cila përftohet me lëndë djegëse. Shumica e këtyre makinerive janë shpikur nga vendet perëndimore. Një kuptim tjetër i këtij emërtimi është se kjo shoqëri do të ishte e zgjuar, por njëkohësisht edhe arrogante, sepse sipas Kuranit, arroganca është vetia e zjarrit. Në një vend thuhet se shejtani u tregua arrogant sepse është krijuar nga zjarri. Në hadithe, shpesh është përmendur që në ditët e vona, Dexhalli do ta mbizotërojë botën, ndërsa Kurani në këtë ajet me fjalët “*këta do të vijnë duke vrapuar nga çdo lartësi*”, dhe shumë hadithe të tjera gjithashtu, pohojnë që Jexhuxhët e Mexhuxhët do ta mbizotërojnë botën. Edhe kjo tregon qartazi se bëhet fjalë për të njëjtën shoqëri, sepse dy grupe të ndryshme nuk mund ta mbizotërojnë botën njëkohësisht. Lexoni edhe 18:100.

104. Nuk do t'i brengosë as gjëma më e madhe dhe engjëjt do t'i takojnë shpesh (e do t'u thonë:) “Kjo është dita juaj që ju premtohetj.”

لَا يَحْزَنُهُمُ الْفَرَعُ الْأَكْبَرُ وَتَتَلَفَّهُمُ  
الْمَلَائِكَةُ هَذَا يَوْمُكُمْ الَّذِي كُنْتُمْ  
تُوعَدُونَ ﴿١٠٤﴾

105. Ditën kur Ne do ta palosim qiellin, siç dorëshkrimet palosen rrotull (boshtit). Ashtu siç e nisëm krijimin e parë, Ne do ta përsërisim atë. Është një premtim që kemi marrë përsipër. Ne patjetër do ta bëjmë këtë.<sup>14</sup>

يَوْمَ نَطْوِي السَّمَاءَ كَطَيِّ السِّجِّيلِ لِلْكُتُبِ  
كَمَا بَدَأْنَا أَوَّلَ خَلْقٍ نُعِيدُهُ وَعَدَّا  
عَلَيْنَا إِنَّا كُنَّا فَاعِلِينَ ﴿١٠٥﴾

106. Dhe Ne e kemi shkruar në Zebur pas këshillës, që tokën do ta trashëgojnë robërit e Mi të dëlirë.<sup>15</sup>

وَلَقَدْ كَتَبْنَا فِي الزَّبُورِ مِنْ بَعْدِ الذِّكْرِ أَنَّ  
الْأَرْضَ يَرِثُهَا عِبَادِيَ الصَّالِحُونَ ﴿١٠٦﴾

107. Sigurisht, në këtë ka mesazh për njerëzit që adhurojnë.<sup>16</sup>

إِنَّ فِي هَذَا لَبَلَاغًا لِقَوْمٍ عَابِدِينَ ﴿١٠٧﴾

14. Kurani i Shenjtë që në shekullin VII bëri disa deklarata që kanë rëndësi të madhe në astronomi. Po në këtë sure tha se qiejt dhe Toka ishin të mbyllura dhe se Allahu i hapi ato e më pas prej ujit krijoi çdo gjë që ka jetë (21:31). Në një ajet tjetër deklaroi se universi po zgjerohet vazhdimisht (51:48). Më pas ky ajet tregon fundin e universit si dhe një fillim të ri. Mesazhi i qartë i këtij ajeti është se universi nuk është i përjetshëm. Ai flet për një të ardhme kur qiejt do të palosen, në një mënyrë të ngjashme siç papiruset palosen rrotull boshtit. Përshkrimet shkencore që ilustrojnë krijimin e një vrimë të zezë, ngjajnë shumë me atë që Kurani paraqet në këtë ajet. Sa më shumë që lënda nga hapësira bie në një vrimë të zezë, siç është e përshkruar më sipër, ajo shtypet për t'u kthyer në një formë çarçafi, nën presionin e madh që krijohet nga forcat gravitacionale dhe elektromagnetike. Ngaqë epiqendra e vrimës së zezë rrotullohet vazhdimisht rreth vetes, edhe çarçafi i lëndës masive, sapo t'i afrohet, fillon të mbështillet rreth saj, para se të zhduket përfundimisht në sferën e së panjohurës. Pas shembjes përfundimtare të universit në një vrimë të zezë, ajeti i mësipërm sjell premtimin e një fillimi të ri. Zoti do të rikrijojë universin, siç Ai e ka bërë më parë. Universi i shembur do të dalë në dritë sërish nga errësira e vet dhe i gjithë procesi i krijimit do të fillojë përsëri. Kjo palosje dhe shpalosje e universit duket të jetë një fenomen i vazhdueshëm, sipas Kuranit të Shenjtë. Lexoni edhe 21:31.

15. Kjo i referohet profecisë së *Hazret Davudit*<sup>as</sup> që përmendet në Bibël, në Psalmet kap. 37.

16. D.m.th. muslimanët duhet të marrin mësim nga kjo, pra, nëse duan ta kenë Palestinën, duhet të bëhen robër të sinqertë të Zotit.



108. Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty, përveçse si mëshirë për botët.<sup>17</sup>

وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا رَحْمَةً لِّلْعَالَمِينَ ﴿١٠٨﴾

109. Thuaj: Mua më shpallet që i Adhureshmi juaj është vetëm Një. Atëherë, a do të bëheni të nënshtuar?

قُلْ إِنَّمَا يُوحِي إِلَيَّ أَنَّمَا إِلَهُكُمُ اللَّهُ وَاحِدٌ ۚ فَهَلْ أَنْتُمْ مُّسْلِمُونَ ﴿١٠٩﴾

110. E nëse ata e kthejnë shpinën, thuaj: Unë ju kam njoftuar ju të gjithë dhe unë nuk e di se ajo që ju premtohet është afër apo larg.

فَإِنْ تَوَلَّوْا فَعَلْنَا أَدْنٰكُمْ عَلَىٰ سَوَاءٍ ۗ وَإِنِ أَدْرِيٓ أَقْرَبُ أَمْ بَعِيدٌ مَّا تُوعَدُونَ ﴿١١٠﴾

111. Pa dyshim, Ai di edhe fjalën që thuhet me zë të lartë, dhe di edhe atë që fshihni.

إِنَّهُ يَعْلَمُ الْجَهْرَ مِنَ الْقَوْلِ وَيَعْلَمُ مَا تَكْتُمُونَ ﴿١١١﴾

112. Dhe unë nuk e di nëse ajo është sprovë për ju a përfitim për një kohë.

وَإِنِ أَدْرِيٓ لَعَلَّهُ فِتْنَةٌ لَّكُمْ وَمَتَاعٌ إِلَىٰ حِينٍ ﴿١١٢﴾

113. (I dërguari) tha: O Zoti im, vendos me drejtësi! Dhe (O mohues!) Zoti ynë është i Gjithëmëshirshmi, të cilit i kërkohet ndihmë kundër asaj që trilloni ju.

قُلْ رَبِّ احْكُم بِالْحَقِّ ۗ وَرَبُّنَا الرَّحْمٰنُ الْمُسْتَعَانُ عَلَىٰ مَا تَصِفُونَ ﴿١١٣﴾

17. Profeti Muhammed<sup>savs</sup> ishte pasqyrim i mëshirës Hyjnore. Ai ishte mëshirë për ndjekësit e tij dhe mëshirë për kundërshtarët e tij. Ai ishte mëshirë për arabët e pashkolluar, të cilët i ngriti nga humnera e shthurjes morale dhe i çoi në majat më të larta të jetës shpirtërore. Ai është mëshirë për brezat e ardhshëm, sepse ua solli Kuranin në të cilin ka mësim dhe udhëzime të sigurta për ta. Ai është mëshirë për mbarë njerëzimin pasi mesazhi i tij nuk kufizohet në ndonjë vend apo popull të caktuar, ndërsa çdo Profet tjetër para tij u dërgua si mëshirë për një popull të caktuar. Nëpërmjet tij kombet e botës janë bekuar siç nuk janë bekuar nga asnjë Profet tjetër. Prandaj, Zoti i ka lënë Profetin Muhammed<sup>savs</sup> lavdërime shumë të veçanta në Kuranin e Shenjtë, siç mund të lexoni në 9:128; 33:57 etj..

## Surja 22 – El-Haxh

Surja El-Haxh është medinase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka shtatëdhjetë e nëntë ajete.

Ajeti i dytë i kësaj sureje alarmon gjithë njerëzit për tërmetin e Kiametit, sepse tashmë ka ardhur një i dërguar i tillë, që u ka bërë thirrje gjithë njerëzve të hynin nën mbrojtjen e të Gjithëmëshirshmit. Pasi ata nuk e pranuan atë, edhe njëherë po u bie kambana që do të ndodhin luftëra kaq të tmerrshme, që do të sjellin pamje kiameti në tokë. Shkatërrimi do të jetë aq fatal, saqë nënat do të harrojnë t'u japin gji fëmijëve të vet, çdo shtatzënë do ta hedhë barrën e saj dhe do të shohësh njerëzit të dehur, ndërkohë nuk do të jenë të dehur, por do të humbasin shqisat për shkak të ndëshkimit të rëndë që do t'u vijë prej Zotit të Madhërishëm.

Kiameti ngre pyetjen se si mund të ringjallen njerëzit përsëri, pasi të jenë shkatërruar një herë? Andaj, kjo sure thotë: Pikërisht Ai Allah që ju krijoi prej dheu për herë të parë, më pas ju kaloi në faza të ndryshme në mitrën e nënës, do t'ju ringjallë sërish.

Më pas thotë se mes njerëzve ka edhe të tillë që adhuron Allahun e Madhërishëm në atë mënyrë, sikur po qëndron buzë një gropë. Për sa kohë që ai gëzon mirësi, qëndron i qetë atje, por sapo vihet në sprovë, bie përmbys në gropë. Njeriu i tillë do të jetë në humbje si në jetën e kësaj bote, ashtu edhe në *ahiret*.

Më pas, përmend shkurtimisht ithtarët e të gjitha feve dhe thotë se Zoti i Madhërishëm do të vendosë mes tyre Ditën e Kiametit.

Pas kësaj, Allahu i Madhërishëm jep urdhër të prerë që njerëzit që duan të vijnë në Qabe për të bërë Haxhin e shtëpisë së Tij, kurrsesi nuk duhen penguar. Menjëherë pas kësaj, kjo sure flet për Shtëpinë e Allahut dhe për porosinë që Ai i dha *Hazret Ibrahim*<sup>as</sup>, që gjithmonë ta mbajë Shtëpinë e Tij të pastër për njerëzit që do të vijnë për të bërë Haxh dhe për të bërë *itikaf*. Kjo porosi nuk është e kufizuar vetëm deri te *Hazret Ibrahim*<sup>as</sup>, por pas tij, pasuesit e tij dhe pasuesit e Profetit Muhammed<sup>savs</sup> janë të obliguar ta zbatojnë atë deri në Ditën e Kiametit.

Më pas i jepet urdhër *Hazret Profetit Muhammed*<sup>savs</sup> që ai të bëjë ftesën e përgjithshme për të gjithë njerëzit që të vijnë në Qabe për të bërë Haxh. Pas kësaj flitet për kurbanet etj., që edhe ato janë ndër gjërat e shenjta të Allahut, sikurse është edhe Qabja e shenjtë. Pra, nëse do t'i çnderoni ato, do të thotë se keni çnderuar edhe Qaben. Gjithashtu, të gjitha kurbanet dhe sakrificat që bëni pranë Qabes, do të pranohen vetëm atëherë kur ato të bëhen me druajtje ndaj Zotit (*takva*), sepse tek Allahu nuk arrin as mishi i kurbaneve, e as gjaku i tyre, por vetëm *takvaja* e atyre që bëjnë kurban.

Pas kësaj, kjo sure hedh dritë gjerësisht mbi xhihadin me armë, ku thotë se vetëm atyre u jepet leje për të zhvilluar këtë lloj xhihadi, të cilët janë persekutuar nga armiqtë dhe që janë dëbuar nga vatrat e tyre, vetëm se thanë se Zoti i tyre është

Allahu. Këtu Kurani i Shenjtë shpalos realitetin e madh se çfarë do të ndodhte nëse muslimanëve të dëbuar e të shtypur nuk do t'u ishte dhënë kjo leje: do të rrëzoheshin jo vetëm xhamitë, por edhe kishat, sinagogat, tempujt dhe faltoret e feve të tjera.

Më pas, duke folur për shkatërrimin e popujve mohues, kjo sure thotë se nëse njeriu shëtit në tokë dhe kërkon rrënojat e popujve të shkatërruar, do të kuptojë se cili ka qenë shkaku i fundit të tyre tragjik. Këtë punë bëjnë arkeologët në kohët tona dhe kanë arritur të zbulojnë rrënojat e shumë prej këtyre popujve.

Në ajetin 53 thuhet se në synimet e të Dërguarit, edhe nëse përfshihet ndonjë dëshirë personale e tij, Zoti i Madhërishëm përmes shpalljes së Tij, ia largon atë. Fjala “shejtan” në këtë ajet nuk nënkupton djallin e mallkuar, por shejtanin që rrjedh në damarët e njeriut, dhe i Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> për këtë tha:

“... por Allahu më ndihmoi kundër tij, dhe ai m'u bë musliman (i nënshtruar)” (Ahmed ibn Hanbel, “Musned”, “Musned Beni Hashim”, vëllimi IV, botues: “Muessesetur-Risāle”, Bejrut 1995, f. 166, hadithi nr. 2323).

Andaj, ky ajet kurrsesi nuk do të thotë se me të vërtetë ndonjë djall intrigon në zemrat e Profetëve të Zotit, sepse në një ajet tjetër të Kuranit (26:222-223), Allahu i Madhërishëm qartazi thotë se djallit nuk i jepet leje as t'u afrohet të Dërguarve të Zotit dhe se ai u zbret njerëzve me karakter të lig. Kështu që, nuk mund të thuhet kurrsesi që djajtë hyjnë në zemrat e të Dërguarve të Zotit.

Në vijim thuhet se të adhuruarit e tyre që ata i barazojnë me Allahun e Madhërishëm nuk kanë fuqi të bëjnë diçka, madje edhe nëse ndonjë mizë u merr ndonjë gjë, ata nuk kanë mundësi ta risjellin atë nga goja e saj. Me të vërtetë kur një mizë lëpin diçka të caktuar, ajo nuk mund të ribëhet në formën e saj të parë, pasi të përzihet me pështymën e mizës dhe pasi të kalojë nga reaksionet kimike në barkun e saj.

Në njërin prej ajeteve të fundit të kësaj sureje, Allahu i Madhërishëm porosit besimtarët të bëjnë xhihad në rrugën e Tij, arsyen e të cilit e ka shpjeguar po në këtë sure pak më parë. Gjithashtu, Zoti i Madhërishëm thotë se Ai Vetë i ka quajtur muslimanë *Hazret Ibrahim*<sup>as</sup>, Profetin Muhammed<sup>savs</sup> dhe ndjekësit e tij. Ai e di më së miri se kush prej njerëzve i nënshtrohet tërësisht.

Në fund, përsëritet deklarata që ky i Dërguar, pra *Hazret Profeti Muhammed*<sup>savs</sup>, është dërguar për të gjithë botën.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. O njerëz! Kini druajtjen ndaj Zotit tuaj. Njëmend, tronditja e Orës do të jetë diçka e madhe!

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ ۚ إِنَّ زَلْزَلَةَ السَّاعَةِ شَيْءٌ عَظِيمٌ ②

3. Ditën kur do të shikoni: çdo gjidhënëse do ta harrojë atë që i jepte gji dhe secila (femër) me barrë do ta hedhë barrën e saj; dhe do t'i shohësh njerëzit të dehur, ndërkohë ata nuk do të jenë të dehur, por ndëshkimi i Allahut do të jetë shumë i rëndë.

يَوْمَ تَرُؤْنَهَا تَذْهَلُ كُلُّ مُرْضِعَةٍ عَمَّا أَرْضَعَتْ وَتَضَعُ كُلُّ ذَاتِ حَمْلٍ حَمْلَهَا وَتَرَى النَّاسَ سُكَارَىٰ وَمَا هُمْ بِسُكَارَىٰ وَلَٰكِنَّ عَذَابَ اللَّهِ شَدِيدٌ ③

4. Prej njerëzve ka të tillë që grinden rreth Allahut, pa pasur dije, dhe ndjekin çdo djall rebel.

وَمِنَ النَّاسِ مَنْ يُجَادِلُ فِي اللَّهِ بِغَيْرِ عِلْمٍ وَيَتَّبِعُ كُلَّ شَيْطَانٍ مَّارٍ ④

5. Për ta është e shkruar që kushdo që do ta bëjë shok atë, ai (pra, djalli) patjetër do ta devijojë dhe do ta prijë drejt zjarrit të ndëshkimit.

كُتِبَ عَلَيْهِ أَنَّهُ مَنْ تَوَلَّاهُ فَإِنَّهُ يُضِلُّهُ وَيَهْدِيهِ إِلَىٰ عَذَابِ السَّعِيرِ ⑤

6. O njerëz! Nëse jeni në mëdyshje për ringjalljen, (ta dini se) Ne ju krijuam prej dheu, pastaj prej sperme, pastaj prej ngjizjeje gjaku, pastaj prej copëze mishi, të formuar pjesërisht dhe jo të formuar pjesërisht, që t'ju tregojmë qartë (sekretet e krijimit). Ne bëjmë të qëndrojnë në mitrat çfarë të duam, deri në një kohë të caktuar, pastaj ju nxjerrim në formë fëmije, që pastaj ju të arrini moshën tuaj të pjekurisë. Dhe prej jush ka që i

يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِن كُنْتُمْ فِي رَيْبٍ مِّنَ الْبَحْثِ فَأَنَّا خَلَقْنَاكُمْ مِّن تَرَابٍ ثُمَّ مِنْ نُطْفَةٍ ثُمَّ مِنْ عَلَقَةٍ ثُمَّ مِنْ مُّضْغَةٍ مُّخَلَّقَةٍ وَغَيْرِ مُخَلَّقَةٍ لِّنُبَيِّنَ لَكُمْ ۗ وَنُقَرُّ فِي الْأَرْحَامِ مَا نَشَاءُ إِلَىٰ آجَلٍ مُّسَمًّى ثُمَّ نُخْرِجُكُمْ طِفْلًا ثُمَّ لِتَبْلُغُوا أَشُدَّكُمْ ۖ وَمِنْكُمْ مَّن يُّتَوَفَّىٰ وَمِنْكُمْ مَّن يُّرَدُّ إِلَىٰ

vjen vdekja dhe po prej jush ka që kthehet në moshën më të pavlerë (të pleqërisë), që pasi të ketë marrë dije, të mos dijë asgjë. Dhe ti sheh tokën të tharë, dhe kur Ne zbresim ujë mbi të, ajo fillon të zhdërvillet, të lulëzojë e të nxjerrë çiftin e çdolloj bime të këndshme.<sup>1</sup>

أَزْدَلِ الْعَمْرِ لِكَيْلَا يَعْلَمَ مِنْ بَعْدِ عِلْمٍ  
شَيْئًا ۖ وَتَرَى الْأَرْضَ هَامِدَةً فَاذًا أَنْزَلْنَا  
عَلَيْهَا الْمَاءَ اهْتَرَّتْ وَرَبَتْ وَأَنْبَتَتْ مِنْ  
كُلِّ رَوْحٍ بِهِيجٌ ۝

7. Kjo është për shkak se Allahu është i Vërteti, se është Ai që ringjall të vdekurit dhe se Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë.

ذَلِكَ بِأَنَّ اللَّهَ هُوَ الْحَقُّ وَأَنَّهُ يُحْيِي الْمَوْتَى  
وَأَنَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ۝

8. Dhe se Ora (e Kiametit) ka për të ardhur; nuk ka dyshim në të dhe se Allahu do t'i ngrejë ata që janë në varre.

وَأَنَّ السَّاعَةَ آتِيَةٌ لَا رَيْبَ فِيهَا ۖ وَأَنَّ اللَّهَ  
يَبْعَثُ مَنْ فِي الْقُبُورِ ۝

9. Prej njerëzve ka edhe të atillë që grindet rreth Allahut, pa pasur as dije, as udhëzim e as ndonjë libër të ndritur,

وَمِنَ النَّاسِ مَنْ يُجَادِلُ فِي اللَّهِ بِغَيْرِ عِلْمٍ  
وَلَا هُدًى وَلَا كِتَابٍ مُبِينٍ ۝

10. kthen kokën (me arrogancë), që të largojë (edhe të tjerët) nga rruga e Allahut. Ai do të ketë poshtërim në këtë botë, kurse në Ditën e Kiametit, Ne do ta bëjmë atë të shijojë ndëshkimin e zjarrit:

ثَانِي عِظْفِهِ لِيُضِلَّ عَنْ سَبِيلِ اللَّهِ ۖ لَهُ فِي  
الدُّنْيَا خِزْيٌ وَنَذِيقُهُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ عَذَابَ  
الْحَرِيقِ ۝

1. Ky ajet shpalos të gjitha etapat e evoluimit të njeriut, madje rendit një nga një ndryshimet që i ndodhin në mitrën e nënës, mu ashtu siç kanë zbuluar shkencëtarët në kohët tona. Prandaj, ky ajet përbën një dëshmi të fuqishme se nuk ishte *Hazret Profeti Muhammed*<sup>savs</sup> që arriti vetë këtë dije, por Zoti i Madhërisëm, që është i Dijshmi i së padukshmes, ia tregoi përmes shpalljes.

Më pas Zoti vijon temën në këtë ajet, duke thënë: Ne i dhamë jetë edhe tokës duke zbritur ujë. Edhe shkencë thotë se tokës së thatë kur i bie shi, asaj i fillojnë shenja jete. Por këtu, tema kryesore duket se shiu shpirtëror që zbriti përmes të Dërguarit të Allahut<sup>savs</sup>, ringjalli një tokë të vdekur, pra një popull që shpirtërisht ishte i vdekur.

11. “Kjo është për shkak të asaj çfarë duart e tua e çuan përpara dhe se, pa dyshim, Allahu nuk u bën aspak padrejtësi robërve”.

12. Prej njerëzve ka edhe të atillë që adhuron Allahun sipërfaqësisht. Nëse i vjen ndonjë e mirë, qetësohet me të dhe nëse i vjen ndonjë sprovë, e kthen kokën pas. Ai humb edhe në këtë botë, edhe në *ahiret*. Kjo pikërisht është humbja e qartë.

13. Ai thërret në vend të Allahut atë që nuk i sjell dot as dëm e as dobi. Ky pikërisht është devijimi i thellë.

14. Ai e thërret atë, dëmi i të cilit është më afër sesa dobia. Eh! I keq kujdestari, i keq shoqëruesi!

15. Pa dyshim, ata që besuan dhe bënë të mira, Allahu do t'i çojë në xhenete nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Allahu bën atë që do.

16. Ai që mendon se Allahu nuk do ta ndihmojë këtë (Profet) në këtë botë dhe në *ahiret*, le të hapë ndonjë rrugë drejt qiellit, më pas le ta shkëpusë (ndihmën), e ta shikojë nëse plani i tij mund ta largojë dot atë që e zemëron!

17. Kështu, Ne e zbritëm atë me shenja të qarta. Allahu udhëzon atë që e do (udhëzimin).

ذٰلِكَ بِمَا قَدَّمْتَ يَدَكَ وَاِنَّ اللّٰهَ لَيَسَّرُ  
لِلْبَاطِلِ لَلْعَيْدِ ۝۱۱

وَمِنَ النَّاسِ مَنْ يَعْبُدُ اللّٰهَ عَلَىٰ حَرْفٍ ۚ  
فَاِنْ اَصَابَهُ خَيْرٌ اَظْمَأَنَّ بِهٖ ۚ وَاِنْ  
اَصَابَتْهُ فِتْنَةٌ اَنقَلَبَ عَلَىٰ وَجْهِهٖ ۗ  
خَسِرَ الدُّنْيَا وَالْآخِرَةَ ۗ ذٰلِكَ هُوَ  
الْخُسْرَانُ الْمُبِينُ ۝۱۲

يَدْعُوْنَ مِنْ دُوْنِ اللّٰهِ مَا لَا يَصُرُّهٗ وَمَا  
لَا يَنْفَعُهٗ ۗ ذٰلِكَ هُوَ الضَّلٰلُ الْبَعِيْدُ ۝۱۳

يَدْعُوْنَ مَنْ صُرُّهٗ اَقْرَبُ مِنْ نَفْعِهٖ ۗ لَيْسَ  
الْمَوْلٰى وَلَيْسَ الْعَشِيْرُ ۝۱۴

اِنَّ اللّٰهَ يَدْخُلُ الَّذِيْنَ اٰمَنُوْا وَعَمِلُوْا  
الصّٰلِحٰتِ جَنَّٰتٍ تَجْرٰى مِنْ تَحْتِهَا الْاَنْهٰرُ ۗ  
اِنَّ اللّٰهَ يَفْعَلُ مَا يَّرِيْدُ ۝۱۵

مَنْ كَانَ يَظُنُّ اَنْ لَّنْ يَنْصُرَهٗ اللّٰهُ فِي الدُّنْيَا  
وَالْآخِرَةِ فَلْيَمْدُدْ بِسَبَبٍ اِلَى السَّمَآءِ ثُمَّ  
لْيَقْطَعْ فَلْيَنْظُرْ هَلْ يُدْهَبْنَ كَيْدُهٗ مَا  
يَغِيْطُ ۝۱۶

وَكَذٰلِكَ اَنْزَلْنٰهُ اِلَيْكَ بِآيٰتٍ ۗ وَاِنَّ اللّٰهَ  
يَهْدِيْ مَنْ يَّرِيْدُ ۝۱۷

18. Ata që besuan, ata që janë hebrej, *sabi'inët*, të krishterët, mexhusët dhe idhujtarët: sigurisht, për ta Allahu do të vendosë Ditën e Kiametit. Allahu është Dëshmitar për çdo gjë.

19. A nuk e pe që kushdo që është në qiej dhe kushdo që është në tokë; dhe dielli, hëna, yjet, malet, pemët, kafshët dhe shumë nga njerëzit i bëjnë sexhde pikërisht Allahut?! Dhe ka shumë të tjerë që kanë merituar ndëshkimin. Atë që e poshtëron Allahu, nuk ka nderues për të. Sigurisht, Allahu bën atë që do.

Sexhdeja VI

20. Këta janë dy (grupe)<sup>2</sup> që grinden rreth Zotit të tyre. Andaj, atyre që mohuan, do t'u priten rroba prej zjarri; mbi koka do t'u hidhet ujë i valuar.

21. Përmes tij do t'u shkrihet çdo gjë që kanë në barkun e tyre, edhe lëkurat.

22. Edhe topuzët prej hekuri i presin ata.

23. Sa herë që ata do të dëshirojnë të dalin prej saj nga brenga, do të detyrohen të rikthehen në të: "Shijoni ndëshkimin e zjarrit!"

إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَالَّذِينَ هَادُوا وَالصَّالِينَ  
وَالنَّصَارَى وَالْمَجُوسَ وَالَّذِينَ أَشْرَكُوا  
إِنَّ اللَّهَ يَفْصَلُ بَيْنَهُمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ ۗ إِنَّ اللَّهَ  
عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ شَهِيدٌ ﴿١٨﴾

أَلَمْ تَرَ أَنَّ اللَّهَ يَسْجُدُ لَهُ مَنْ فِي السَّمَوَاتِ  
وَمَنْ فِي الْأَرْضِ وَالشَّمْسُ وَالْقَمَرُ  
وَالنُّجُومُ وَالْجِبَالُ وَالشَّجَرُ وَالدَّوَابُّ  
وَكَثِيرٌ مِّنَ النَّاسِ ۗ وَكَثِيرٌ حَقَّ عَلَيْهِ  
الْعَذَابُ ۗ وَمَنْ يُهِنِ اللَّهُ فَمَا لَهُ مِنْ  
مُكْرِمٍ ۗ إِنَّ اللَّهَ يَفْعَلُ مَا يَشَاءُ ﴿١٩﴾

السجدة ٦

هَذَانِ حَصْنٍ اخْتَصَمُوا فِي رَبِّهِمْ  
فَالَّذِينَ كَفَرُوا قُطِّعَتْ لَهُمْ ثِيَابٌ مِّن  
نَّارٍ ۖ يُصَبُّ مِنْ فَوْقِ رُءُوسِهِمُ  
الْحَمِيمُ ﴿٢٠﴾

يُصْهَرُ بِهِ مَا فِي بُطُونِهِمْ وَالْجُلُودُ ﴿٢١﴾

وَلَهُمْ مَقَامِعٌ مِّنْ حَدِيدٍ ﴿٢٢﴾

كَلِمًا أَرَادُوا أَنْ يَخْرُجُوا مِنْهَا مِنْ غَمٍّ  
عَظِيمٍ ۖ وَأَعِيدُوا فِيهَا وَذُقُوا عَذَابَ الْحَرِيقِ ﴿٢٣﴾

2. D.m.th. besimtarët dhe mohuesit.

24. Sigurisht, ata që besuan dhe bënë të mira, Allahu do t'i çojë në xhenete, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Në to ata do të vishen me byzylykë ari dhe perla. Veshja e tyre në to do të jetë prej mëndafshi.

25. Ata do të udhëzohen drejt fjalës së pastër dhe do të udhëzohen drejt rrugës së të Lavdëruarit.

26. Ata që mohuan dhe penguan nga rruga e Allahut dhe nga Xhamia e shenjtë, të cilën e bëmë për gjithë njerëzit, si të barabartë për qëndruesit në të (për hir të Zotit) dhe për vizitorët, (ta dinë se) ai që dëshiron shtrembësi në të mizorisht, do ta bëjmë të shijojë ndëshkim të dhimbshëm.

27. Dhe kur i përgatitëm Ibrahimit vendin e Shtëpisë (të Qabes, duke e porositur): Asgjë mos bëj ortak me Mua dhe pastroje Shtëpinë Time për ata që sillen rreth saj, për ata që rrinë në këmbë, dhe për ata që përkulen (dhe) bëjnë sexhde.<sup>3</sup>

28. Dhe njofto mes njerëzve për Haxhin! Do të të vijnë në këmbë, të hipur në kafshë të rraskapitura (nga udhëtime të gjata); do të vijnë nga çdo rrugë e thellë (dhe) e largët.

إِنَّ اللَّهَ يُدْخِلُ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ يُحَلَّوْنَ فِيهَا مِنْ أَسَاوِرَ مِنْ ذَهَبٍ وَّلُؤْلُؤًا ۖ وَبِاسْتِمْهَمُّ فِيهَا حَرِيرٌ ۗ

وَهُدُّوْا إِلَى الطَّيِّبِ مِنَ الْقَوْلِ ۗ وَهُدُّوْا إِلَى صِرَاطِ الْحَمِيدِ ۗ

إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا وَيَصُدُّوْنَ عَنْ سَبِيلِ اللَّهِ وَالْمَسْجِدِ الْحَرَامِ الَّذِي جَعَلْنَاهُ لِلنَّاسِ سَوَاءً ۖ الْعَاكِفِ فِيهِ وَالْبَادِ ۗ وَمَنْ يُرِدْ فِيهِ بِإِلْحَادٍ بِظُلْمٍ نُذِقْهُ مِنْ عَذَابٍ عَاجِلٍ ۗ

وَإِذْ بَوَّأْنَا لِإِبْرَاهِيمَ مَكَانَ الْبَيْتِ أَنْ لَا تُشْرِكْ بِي شَيْئًا ۚ وَطَهِّرْ بَيْتِيَ لِلطَّائِفِينَ وَالْقَائِمِينَ وَالرُّكَّعِ السُّجُودِ ۗ

وَأَذِّنْ فِي النَّاسِ بِالْحَجِّ يَأْتُوكَ رِجَالًا ۖ وَعَلَى كُلِّ ضَامِرٍ يَأْتِينَ مِنْ كُلِّ فَجٍّ عَمِيقٍ ۗ

3. Ky ajet paraqet skicën e faljes islame, pra të namazit, në të cilin ka edhe qëndrim në këmbë (*kijam*), edhe përkulje (*ruku*) si dhe sexhde. Për Qabën lexoni 2:128, kurse për kohët e namazit lexoni 20:131.



29. Që të dëshmojnë dobitë (që janë caktuar) për ta dhe të përmendin emrin e Allahut në ditë të shënuara, për atë (mirësi) që Ai ua dha nga bagëtitë.<sup>4</sup> Hani prej tyre dhe ushqeni nevojtarët e varfër.

لِيَشْهَدُوا مَنَافِعَ لَهُمْ وَيَذْكُرُوا اسْمَ اللَّهِ  
فِي أَيَّامٍ مَّعْلُومَاتٍ عَلَىٰ مَا رَزَقَهُم مِّن  
بِهِمَّةٍ ۖ الْأَنْعَامِ ۖ فَكُلُوا مِنْهَا وَأَطِيعُوا  
أَوَاثِينَ الْفُقَرَاءِ ﴿٢٩﴾

30. Më pas, le të largojnë zhulin e (mëkateve të) tyre, të përmbushin betimet e tyre dhe të sillen rreth Shtëpisë së lashtë.

ثُمَّ لِيُقْضَىٰ أَهْلِيهِمْ وَيُؤْفَأُوا ۚ لِيُذَوُّهُمْ  
وَلِيُطَوَّفُوا بِالْبَيْتِ الْعَتِيقِ ﴿٣٠﴾

31. Kjo është (porosia). Dhe kushdo që madhëron të shenjtat e Allahut, është mirë për të pranë Zotit të tij. Ju lejohen bagëtitë, përveç atyre që ju janë përmendur. Kështu që, ruhuni nga ndyrësia e idhujve dhe ruhuni nga gënjeshtria;

ذٰلِكَ ۗ وَمَنْ يُعْظَمْ حُرْمَتِ اللَّهِ فَهُوَ خَيْرٌ  
لَّهُ عِنْدَ رَبِّهِ ۗ وَأُحِلَّتْ لَكُمُ الْأَنْعَامُ إِلَّا  
مَا يُتْلَىٰ عَلَيْكُمْ ۖ فَاجْتَنِبُوا الرِّجْسَ مِنَ  
الْأَوْثَانِ وَاجْتَنِبُوا قَوْلَ الزُّورِ ﴿٣١﴾

32. (dhe) jini të anuar drejt Allahut, duke mos bërë dikë ortak me Të. Dhe ai që bën dikë a diçka ortak me Allahun, është sikur të jetë i rrëzuar prej qiellit, atëherë zogjtë do ta rrëmbejnë atë ose era do ta hedhë tej në një vend të largët.

حُفَاءَ لِلَّهِ غَيْرَ مُشْرِكِينَ بِهِ ۗ وَمَنْ يُشْرِكْ  
بِاللَّهِ فَكَأَنَّمَا خَرَّ مِنَ السَّمَاءِ فَتَخْطَفُهُ  
الطَّيْرُ أَوْ تَهْوَىٰ بِهِ الرِّيحُ فِي مَكَانٍ  
سَعِيْقٍ ﴿٣٢﴾

33. Kjo është (porosia). Dhe kushdo që madhëron shenjtat e Allahut, kjo pa dyshim është devotshmëria e zemrave.

ذٰلِكَ ۗ وَمَنْ يُعْظَمْ شَعَائِرَ اللَّهِ فَإِنَّهَا مِنْ  
تَقْوَى الْقُلُوبِ ﴿٣٣﴾

34. Do të keni përfitime nga këto (bagëti) deri në një kohë të caktuar, më pas ato duhen çuar drejt Shtëpisë së lashtë.

لَكُمْ فِيهَا مَنَافِعٌ إِلَىٰ أَجَلٍ مُّسَمًّى ۖ ثُمَّ  
مَحْلُوهَا إِلَى الْبَيْتِ الْعَتِيقِ ﴿٣٤﴾

4. Ky ajet mund të përkthehet edhe: "... dhe të përmendin emrin e Allahut në ditë të shënuara mbi bagëtitë që Ai ua dha..."

35. Dhe për çdo popull kemi caktuar një mënyrë sakrificimi, që ata të përmendin emrin e Allahut mbi ato që Ai ua dha prej bagëtie. Pra, i Adhureshmi juaj është Një i Adhureshëm, andaj, Atij nënshtrojeni. Jepu lajm të mirë të përrulurve;

وَلِكُلِّ أُمَّةٍ جَعَلْنَا مَنَسَكًا لِّيُذَكَّرُوا  
اسْمَ اللَّهِ عَلَى مَا رَزَقَهُمْ مِنْ بَهِيمَةٍ  
الْأَنْعَامِ ۖ فَالْهَيْكُمُ إِلَهُ وَاحِدٌ فَلَهُ أَسْلِمُوا ۗ<sup>ط</sup>  
وَبَشِّرِ الْمُحْسِنِينَ ۝

36. atyre, që kur u përmendet Allahu, u drithërohen zemrat; dhe të duruarve për atë që i goditi, falësve të namazit dhe atyre që shpenzojnë nga ajo që u kemi dhënë.

الَّذِينَ إِذَا ذُكِرَ اللَّهُ وَجِلَتْ قُلُوبُهُمْ  
وَالصَّابِرِينَ عَلَى مَا أَصَابَهُمُ وَالْمُقِييِي  
الصَّلَاةِ ۗ وَمِمَّا رَزَقْنَاهُمْ يُنْفِقُونَ ۝

37. Edhe në devetë e kurbanit që Ne ju kemi bërë prej shenjave të Allahut, ka mirësi për ju. Andaj, përmendni emrin e Allahut mbi to, duke i rreshtuar në këmbë. Kur ato ulen në tokë (pas therjes), hani prej tyre dhe ushqeni edhe atë që nuk lyp, edhe lypësin. Ne kështu jua kemi nënshtuar ato, që ju të falënderoni.

وَالْبُدْنَ جَعَلْنَاهَا لَكُمْ مِنْ سَعَائِرِ اللَّهِ لَكُمْ  
فِيهَا حَيْرٌ ۗ فَأَذْكُرُوا اسْمَ اللَّهِ عَلَيْهَا  
صَوَافٍ ۚ فَإِذَا وَجَبَتْ جُنُوبُهَا فَكُلُوا مِنْهَا  
وَأَطْعَمُوا الْقَانِعَ وَالْمُعْتَرَّ ۗ كَذَلِكَ  
سَخَّرْنَاهَا لَكُمْ لَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ ۝

38. Kurrsesi nuk i arrijnë Allahut as mishi i tyre, e as gjaku i tyre, por i arrin druajtja (dhe devotshmëria) juaj. Ai kështu jua ka nënshtuar ato, që ju ta madhëroni Allahun për atë që Ai ju udhëzoi. Jepu lajmin e mirë mirëbërësve.

لَنْ يَنَالَ اللَّهُ لُحُومَهَا وَلَا دِمَآؤَهَا  
وَلَكِنْ يَنَالُهُ التَّقْوَى مِنْكُمْ ۗ كَذَلِكَ  
سَخَّرَهَا لَكُمْ لِتُكَبِّرُوا اللَّهَ عَلَى مَا  
هَدَيْكُمْ ۗ وَبَشِّرِ الْمُحْسِنِينَ ۝

39. Sigurisht, Allahu i mbron ata që besuan. Sigurisht, Allahu nuk do asnjë të pandershëm, mosmirënjohës.<sup>5</sup>

إِنَّ اللَّهَ يُدْفِعُ عَنِ الَّذِينَ آمَنُوا ۗ إِنَّ اللَّهَ  
عَلِيمٌ ذَكِيمٌ ۝ لَا يُحِبُّ كُلَّ خَوَّانٍ كَفُورٍ ۝

5. Me këtë ajet fillon tema e *xhihadit*. Tema e sakrificës ka shërbyer si një prelud i përshtatshëm për këtë temë shumë të rëndësishme. Pra, para se t'u jepej leja muslimanëve për të luftuar në vetëmbrojtje, ata ishin të informuar për rëndësinë e sakrificës. Këto ajete hedhin dritë mbi

40. Atyre që janë sulmuar, u lejohej (që të mbrohen), sepse u është bërë padrejtësi. Njëmend, Allahu është i Plotfuqishëm që t'i ndihmojë ata,<sup>6</sup>

أَذِنَ لِلَّذِينَ يُقْتَلُونَ بِأَنَّهُمْ ظَلَمُوا ۗ وَإِنَّ  
اللَّهَ عَلَىٰ نَصْرِهِمْ لَقَدِيرٌ ﴿٤٠﴾

41. ata që janë dëbuar nga shtëpitë e tyre padrejtësisht, vetëm se thanë: “Zoti ynë është Allahu”.<sup>7</sup> Sikur Allahu të mos u kishte dhënë njerëzve mundësinë për t'u mbrojtur nga njëri-tjetri, do të shkatërroheshin manastiret, kishat, sinagogat dhe xhamitë, në të cilat përmendet shumë emri i Allahut. Allahu patjetër do ta ndihmojë atë që do të ndihmojë Allahun. Sigurisht, Allahu është i Fortë, i Plotfuqishëm.<sup>8</sup>

الَّذِينَ أُخْرِجُوا مِنْ دِيَارِهِمْ بِغَيْرِ حَقٍّ إِلَّا  
أَنْ يَقُولُوا رَبَّنَا اللَّهُ ۗ وَلَوْلَا دَفْعُ اللَّهِ  
النَّاسَ بَعْضَهُمْ بِبَعْضٍ لَفُتِنَتِ صَوَائِعُ  
وَبِيعٌ وَصَلَوَاتٌ وَ مَسْجِدٌ يُذَكَّرُ فِيهَا  
اسْمُ اللَّهِ كَثِيرًا ۗ وَلَيَنْصُرَنَّ اللَّهُ مَنْ  
يُنْصُرُهُ ۗ إِنَّ اللَّهَ لَقَوِيٌّ عَزِيزٌ ﴿٤١﴾

42. Janë ata, të cilët po t'i forcojmë në tokë, do të falin namazin, do të

الَّذِينَ إِنْ مَكَّنَّاهُمْ فِي الْأَرْضِ أَقَامُوا  
الصَّلَاةَ وَآتَوُا الزَّكَاةَ وَآمَرُوا

konceptimin islam të xhihadit me armë. Xhihadi do të bëhej në mbrojtje të së vërtetës. Islami nuk lejon luftë agresive në emër të fesë, megjithatë, sipas Islamit është shumë e rëndësishme edhe liria e ndërgjegjes, liria për të praktikuar besimin. Pikërisht në mbrojtje të kësaj pasurie më të çmuar jo vetëm të muslimanëve, por siç pohojnë ajetet në vijim, të të gjitha besimeve fetare, muslimanëve iu lejua t'i kundërpërgjigjeshin luftës me të njëjtën monedhë.

6. Sipas studivesve, ky është ajeti i parë që u dha muslimanëve lejen për të marrë armët në vetëmbrojtje. Ajeti parashtron kushtet në të cilat muslimanët u detyruan të bënin luftën mbrojtëse, sepse atyre u ishte bërë padrejtësi.

7. Ky ajete tregon arsyen e dytë pse muslimanëve iu dha e drejta për të luftuar, dhe ajo është se ata u përballën me 13 vite persekutime tepër të rënda dhe më pas edhe me braktisjen e vatanit, vetëm për shkak të besimit dhe jo për ndonjë shkak tjetër. Pastaj, mekasit nuk i lanë të qetë as në mërgim. Në këto rrethana ku Islami u kërcënua të zhdukej nga sulmet e mekasve nga jashtë, dhe nga kurthet e hebrejve nga brenda Medinës, e vetmja rrugë për muslimanët ishte lufta mbrojtëse. Realisht, ky mund të ishte shkak më i madh që mund t'i siguronte një populli të drejtën për vetëmbrojtje. Megjithatë, disa kritikë padrejtësisht akuzojnë Islamit se gjoja ka bërë luftëra për të imponuar besimin.

8. Pasi përmendi arsyet pse muslimanët ishin të detyruar të merrnin armët, ajeti përmend objektin dhe qëllimin e luftërave të Islamit. Muslimanët luftuan për vetëmbrojtje, për të shpëtuar Islamit nga shfarosja dhe për të vendosur lirinë e ndërgjegjes dhe lirinë e mendimit, gjithashtu edhe për të mbrojtur vendet e adhurimit që u përkisnin feve të tjera, pra kishat, sinagogat, tempujt, manastiret, etj. (2:194; 2:257; 8:40; 8:73).

japin zekatin, do të urdhërojnë për mirësi dhe do të ndalojnë nga e keqja. Tek Allahu është fundi i çështjeve.<sup>9</sup>

بِالْمَعْرُوفِ وَنَهَوْا عَنِ الْمُنْكَرِ ۗ وَاللَّهُ  
عَاقِبَةُ الْأُمُورِ ﴿٤٧﴾

43. Nëse të quajnë gënjeshtar, kështu kanë përgënjeshtuar para tyre populli i Nuhut, (gjithashtu) edhe adët dhe themudët;

وَإِنْ يُكَذِّبُوكَ فَقَدْ كَذَّبَتْ قَبْلَهُمْ قَوْمُ  
نُوحٍ وَعَادٌ وَتَمُودٌ ﴿٤٨﴾

44. dhe populli i Ibrahimit dhe i Lutit;

وَقَوْمِ إِبْرَاهِيمَ وَقَوْمِ لُوطٍ ﴿٤٩﴾

45. dhe njerëzit e Medjenit. E quajten gënjeshtar edhe Musain, atëherë Unë u dhashë pak kohë mohuesve, më pas i kapa. Si ishte ndëshkimi Im?!

وَاصْحَابِ مَدْيَنَ ۚ وَكَذَّبَ مُوسَىٰ فَأَمَلَيْتُ  
لِلْكَافِرِينَ ۚ ثُمَّ أَخَذْتَهُمْ ۚ فَكَيْفَ كَانَ  
نَكِيرِ ﴿٥٠﴾

46. Sa shumë vendbanime ka që Ne i shkatërruam, kur ato bënë padrejtësi! E tanimë ato janë të rëna përmbys. Dhe sa shumë puse të braktisura dhe kështjella të sigurta (që i trajtuam po kështu)!

فَكَانَ مِنْ قَرْيَةٍ أَهْلَكْنَاهَا وَهِيَ ظَالِمَةٌ  
فَهِيَ حَاوِيَةٌ عَلَىٰ عُرُوشِهَا وَبِئْرٍ مُّعَطَّلَةٍ  
وَقَصْرِ مَشِيدٍ ﴿٥١﴾

9. Ky ajet parashikon se çfarë duhet të bënë muslimanët pasi ta mundnin armikun e tyre. Muslimanët e vërtetë janë ata të cilët i ndihmon Allahu, siç u premtua në ajetin e mëparshëm, dhe të cilët pasi gëzojnë sundimin, nuk e përdorin forcën për ta zgjeruar pushtetin për qëllime egoiste, përkundrazi, adhurojnë Zotin, ndihmojnë nevojtarët, predikojnë të mirën dhe ndalojnë nga e keqja. Siç u pa në këto ajete, shkaku kryesor që iu lejua muslimanëve të merrnin armët ishte për lirinë fetare. Dhe Allahu ua premtoi që do të ishte Ai Ndhimësi i tyre në këtë kauzë të shenjtë. Luftërat që u zhvilluan gjatë epokës së parë të Islamit, janë dëshmitare edhe të ekzistencës së shkakut, edhe të ndihmës së jashtëzakonshme të Zotit. Sot muslimanët thuajse në të gjithë botën gëzojnë lirinë fetare. Andaj, themeluesi i Xhematit Musliman Ahmedia që deklaroi të jetë Mesih i Premtuar e Imam Mehdi, u bëri thirrje gjithë muslimanëve të botës që xhihadi me armë në këtë kohë nuk aplikohet dhe se kushdo që do të ndërmarrë një xhihad të tillë, nuk do ta gëzojë premtimin e Zotit që përmendet në këto ajete, përkundrazi, do të poshtërohet nga kundërshtarët. Deklarata e tij erdhi sipas profesisë së vetë Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, ku ai tha se Mesihu i Premtuar “do ta ndërpresë luftën (fetare)” (Askalani, Sherh Buhari, nr. 3448) dhe se në kohën e tij “lufta (fetare) do të dorëzojë armët e saj” (Musned Ahmed, nr. 9323). Lexoni edhe 25:53.

47. A nuk kanë shëtitur në tokë, që të kishin zemra që të kuptonin përmes tyre dhe veshë që të dëgjonin prej tyre?! Sepse në të vërtetë, nuk verbohen sytë, por verbohen zemrat që janë në kraharorë.

48. Ata të kërkojnë që të vijë shpejt ndëshkimi, kurse Allahu kurrë nuk e shkel premtimin e Tij. Pa dyshim, një ditë te Zoti yt është sa një mijë vjet që numëroni ju.

49. Dhe sa shumë vendbanime ka që u dhashë kohë, kur ato bënëin padrejtësi. Më pas i kapta. Tek Unë është kthimi.

50. Thuaj: O njerëz! Unë jam vetëm një alarmues i qartë për të gjithë ju.

51. Ata që besuan dhe bënë të mira, do të kenë falje dhe dhuratë të nderuar.

52. Dhe ata që u orvatën për t'i mposhtur shenjat Tona, janë banorë të xhehenemit.

53. Dhe çdo të dërguar a profet që kemi dërguar para teje, kur ai pati ndonjë dëshirë, shejtani (i *nefsit*) hodhi diçka në dëshirat e tij. Atëherë, Allahu e largon atë që hedh shejtani, më pas Allahu vendos ajetet e Tij. Allahu është i Gjithëdijshëm, i Urtë.<sup>10</sup>

أَفَلَمْ يَسِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَتَكُون لَهُمْ قُلُوبٌ يَعْقِلُونَ بِهَا أَوْ آذَانٌ يَسْمَعُونَ بِهَا فَإِنَّهَا لَا تَعْمَى الْأَبْصَارُ وَلَكِنْ تَعْمَى الْقُلُوبُ الَّتِي فِي الصُّدُورِ ﴿٤٧﴾

وَيَسْتَعْجِلُونَكَ بِالْعَذَابِ وَلَنْ يُخْلِفَ اللَّهُ وَعْدَهُ وَإِنَّ يَوْمًا عِنْدَ رَبِّكَ كَأَلْفِ سَنَةٍ مِّمَّا تَعُدُّونَ ﴿٤٨﴾

وَكَأَيِّن مِّن قَرْيَةٍ أَمَلَيْتُ لَهَا وَهِيَ ظَالِمَةٌ لَّهَا ثُمَّ أَخَذْتَهَا وَإِلَى الْمَصِيرِ ﴿٤٩﴾

قُلْ يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنَّمَا أَنَا لَكُمْ نَذِيرٌ مُّبِينٌ ﴿٥٠﴾

فَالَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَهُمْ مَغْفِرَةٌ وَأَرْزُقًا كَرِيمٌ ﴿٥١﴾

وَالَّذِينَ سَعَوْا فِي آيَاتِنَا مُعْجِزِينَ أُولَٰئِكَ أَصْحَابُ الْجَحِيمِ ﴿٥٢﴾

وَمَا أَرْسَلْنَا مِنْ قَبْلِكَ مِنْ رَسُولٍ وَلَا نَبِيٍّ إِلَّا إِذَا تَمَنَّى الْقَى الشَّيْطَانُ فِي أُمْنِيَّتِهِ فَيَنسَخُ اللَّهُ مَا يُلْقَى الشَّيْطَانُ ثُمَّ يُحْكِمُ اللَّهُ آيَتِهِ وَاللَّهُ عَلِيمٌ حَكِيمٌ ﴿٥٣﴾

10. Lexoni në parathënien e sures shpjegimin e këtij ajeti.

54. Që (Allahu) ta bëjë atë që hedh shejtani, sprovë për ata që kanë sëmundje në zemrat e tyre dhe që u janë ngurtësuar zemrat. Pa dyshim, keqbërësit kanë përfunduar në një kundërshtim të largët.

لِيَجْعَلَ مَا يُلْقَى الشَّيْطَانُ فِتْنَةً لِلَّذِينَ  
فِي قُلُوبِهِمْ مَّرَضٌ وَالْقَاسِيَةِ قُلُوبَهُمْ ط  
وَإِنَّ الظَّالِمِينَ لَفِي شِقَاقٍ بَعِيدٍ ٥٤

55. Dhe që atyre që u është dhënë dija, ta kuptojnë se kjo është e vërteta prej Zotit tënd, si dhe ta besojnë atë dhe t'u përulen zemrat ndaj saj. Dhe ata që besuan, Allahu patjetër do t'i udhëzojë drejt rrugës së drejtë.

وَ لِيَعْلَمَ الَّذِينَ أُوتُوا الْعِلْمَ أَنَّهُ الْحَقُّ  
مِن رَّبِّكَ فَيُؤْمِنُوا بِهِ فَتُخْبِتَ لَهُ قُلُوبُهُمْ ط  
وَإِنَّ اللَّهَ لَهُدِ الَّذِينَ آمَنُوا إِلَىٰ صِرَاطٍ  
مُسْتَقِيمٍ ٥٥

56. Dhe ata që mohuan gjithnjë do të mbeten në mëdyshje rreth saj, derisa atyre do t'u vijë Ora befas ose do t'u vijë ndëshkimi i një dite shterpë.

وَلَا يَرَأِ الَّذِينَ كَفَرُوا فِي مَرِيَّةٍ مِنْهُ  
حَتَّىٰ تَأْتِيَهُمُ السَّاعَةُ بَغْتَةً أَوْ يَأْتِيَهُمْ  
عَذَابٌ يَوْمٍ عَقِيمٍ ٥٦

57. Sundimi atë ditë do të jetë i Allahut. Ai do të gjykojë mes tyre. Atëherë, ata që besuan dhe bënë të mira, do të jenë në xhenete të begatshme.

الْمَلِكِ يَوْمَئِذٍ لِلَّهِ ط يَحْكُمُ بَيْنَهُمْ ط  
فَأَلَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ فِي جَنَّاتِ  
التَّعِيمِ ٥٧

58. Kurse ata që mohuan dhe i quajtën gënjeshtër shenjat Tona, do të kenë ndëshkim poshtëruës.

وَالَّذِينَ كَفَرُوا وَكَذَّبُوا بِآيَاتِنَا فَأُولَٰئِكَ  
لَهُمْ عَذَابٌ مُّهِينٌ ٥٨

59. Ata që mërguan në rrugën e Allahut, më pas u vranë ose vdiqën, Allahu patjetër do t'u japë ushqime (e dhurata) të mira. Dhe sigurisht, Allahu është Dhënësi më i mirë.

وَالَّذِينَ هَاجَرُوا فِي سَبِيلِ اللَّهِ ثُمَّ قُتِلُوا  
أَوْ مَاتُوا لَيَرْزُقَنَّهُمُ اللَّهُ رِزْقًا حَسَنًا ط  
وَإِنَّ اللَّهَ لَهُوَ خَيْرُ الرَّزُقِينَ ٥٩

60. Ai patjetër do t'i çojë në hyrje, që ata do ta pëlqejnë. Dhe pa dyshim, Allahu është i Gjithëdijshëm, i Përmbajtur.

لِيُدْخِلَنَّهُمْ مُّدْخَلًا يَرْضَوْنَهُ ط وَإِنَّ اللَّهَ  
لَعَلِيمٌ حَلِيمٌ ٦٠

61. Kështu është. Ai që shtrëngon (dikë), aq sa ai u shtrëngua (prej atij), më pas i bëhet mizori (për këtë shkak), Allahu patjetër do ta ndihmojë atë. Sigurisht, Allahu është shumë Tolerues, shumë Falës;

ذٰلِكَ ۚ وَمَنْ عَاقَبَ بِمِثْلِ مَا عُوْقِبَ بِهٖ  
ثُمَّ بَغَىٰ عَلَيْهِ لِيُنْصِرْهُ اللّٰهُ ۗ اِنَّ اللّٰهَ لَعَفُوٌّ  
غَفُوْرٌ ﴿١١﴾

62. sepse pikërisht Allahu fut natën në ditë dhe e fut ditën në natë dhe se pikërisht Allahu është Gjithëdëgjues, Gjithëshikues.

ذٰلِكَ بِاَنَّ اللّٰهَ يُوْجِبُ اَیُّوْمَ النَّهَارِ وَيُوْجِبُ  
النّٰهَارَ فِی الْاَیُّوْمِ ۗ وَاَنَّ اللّٰهَ سَمِیْعٌ بَصِیْرٌ ﴿١٢﴾

63. Kështu është, sepse pikërisht Allahu është i Vërteti dhe ajo që ata adhurojnë në vend të Tij është e rrema, dhe se pikërisht Allahu është i Larti, i Madhi.

ذٰلِكَ بِاَنَّ اللّٰهَ هُوَ الْحَقُّ وَاَنَّ مَا يَدْعُوْنَ مِنْ  
دُوْنِهٖ هُوَ الْبَاطِلُ ۗ وَاَنَّ اللّٰهَ هُوَ الْعَلِيُّ  
الْكَبِيْرُ ﴿١٣﴾

64. A nuk e sheh që Allahu zbriti ujë prej qiellit dhe toka është bërë e gjelbëruar. Pa dyshim, Allahu është i Mprehtë, i Gjithinformuar.

اَلَمْ تَرَ اَنَّ اللّٰهَ اَنْزَلَ مِنَ السَّمَآءِ مَآءً  
فَتَنْصِبُحُ الْاَرْضَ مُخْضِرَةً ۗ اِنَّ اللّٰهَ لَطِيْفٌ  
خَبِيْرٌ ﴿١٤﴾

65. E Atij është ajo që është nëpër qiej dhe ajo që është në tokë dhe se pikërisht Allahu është i Vetëmjaftueshmi, i Lavdëruari.

لَهُ مَا فِی السَّمٰوٰتِ وَمَا فِی الْاَرْضِ ۗ وَاِنَّ  
اللّٰهَ لَهُوَ الْعَنِيُّ الْحَمِيْدُ ﴿١٥﴾

66. A nuk e sheh se Allahu nënshtroi për ju gjithçka që është në tokë, si dhe anijet; ato lundrojnë në det me urdhrin e Tij. Ai e mban qiellin që të mos bjerë në tokë, përveçse me urdhrin e Tij. Sigurisht, Allahu ndaj njerëzve është shumë i Dhembshur, shumë Mëshirëbërës.<sup>11</sup>

اَلَمْ تَرَ اَنَّ اللّٰهَ سَخَّرَ لَكُمْ مَّا فِی الْاَرْضِ  
وَالْفُلْكَ تَجْرِی فِی الْبَحْرِ بِاَمْرِهٖ ۗ وَيُمْسِكُ  
السَّمَآءَ اَنْ تَقَعَ عَلٰی الْاَرْضِ اِلَّا بِاِذْنِهٖ ۗ  
اِنَّ اللّٰهَ بِالنَّاسِ لَرَءُوْفٌ رَّحِيْمٌ ﴿١٦﴾

11. Pra, Zoti i Madhërishtëm ka vendosur barriera të shumta, në mënyrë që pa urdhrin e Tij, bota të mos pësojë ndonjë ndëshkim të madh.

67. Është Ai që ju dha jetë, më pas do t'ju japë vdekje, e sërish do t'ju japë jetë. Njëmend, njeriu është shumë mosmirënjohës.

68. Për çdo popull kemi bërë një mënyrë sakrifikimi, sipas së cilës ata sakrifikojnë. Andaj, ata nuk duhet të grinden me ty në këtë çështje dhe ti thirri drejt Zotit tënd. Pa dyshim, ti je në rrugë të drejtë.

69. Nëse ata grinden me ty, thuaj: Allahu e di më së miri atë që bëni.

70. Allahu do të gjykojë mes jush Ditën e Kiametit në ato që ju kundërshtonit.

71. A nuk e di se Allahu di gjithçka që është në qiej dhe tokë?! (E gjithë) kjo është në një Libër. Sigurisht, kjo është e lehtë për Allahun.

72. Ata adhurojnë në vend të Allahut diçka për të cilën Ai nuk zbriti ndonjë argument dhe për të cilën ata as nuk kanë ndonjë dije. Të padrejtët nuk do të kenë asnjë ndihmës.

73. Kur atyre u lexohen ajetet Tona të qarta, ti njeh kundërshtimin në fytyrat e atyre që mohuan. Janë gati t'u vërsulen atyre që ua lexojnë ajetet Tona. Thuaju: A t'ju tregoj për diçka më të keqe se kjo? Zjarri! Këtë Allahu ua premtoi atyre që mohuan. Sa kthim i keq qenka ai!

وَهُوَ الَّذِي أَحْيَاكُمْ ثُمَّ يُمِيتُكُمْ ثُمَّ يُحْيِيكُمْ ۗ إِنَّ الْإِنْسَانَ لَكَفُورٌ ﴿١٧﴾

لِكُلِّ أُمَّةٍ جَعَلْنَا مَنْسَكًا هُمْ نَاسِكُوهُ فَلَا يُبَارِعُكَ فِي الْأَمْرِ وَاذْعُ إِلَىٰ رَبِّكَ ۗ إِنَّكَ لَعَلَىٰ هُدًى مُّسْتَقِيمٍ ﴿١٨﴾

وَأِنْ جَدُّوكَ فَقُلِ اللَّهُ أَعْلَمُ بِمَا تَعْمَلُونَ ﴿١٩﴾

اللَّهُ يَحْكُمُ بَيْنَكُمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ فِيمَا كُنْتُمْ فِيهِ تَخْتَلِفُونَ ﴿٢٠﴾

أَلَمْ تَعْلَمْ أَنَّ اللَّهَ يَعْلَمُ مَا فِي السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ ۗ إِنَّ ذَلِكَ فِي كِتَابٍ ۗ إِنَّ ذَلِكَ عَلَىٰ اللَّهِ يَسِيرٌ ﴿٢١﴾

وَيَعْبُدُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ مَا لَمْ يَنْزِلْ بِهِ سُلْطَانًا ۗ وَمَا لَيْسَ لَهُمْ بِهِ عِلْمٌ ۗ وَمَا لِلظَّالِمِينَ مِنْ نَصِيرٍ ﴿٢٢﴾

وَإِذَا تُلِيٰ عَلَيْهِمُ آيَاتُنَا بِبَيِّنَاتٍ تَعْرِفُ فِي وُجُوهِ الَّذِينَ كَفَرُوا الْمُنْكَرَ ۗ يَكَادُونَ يَسْطُونَ بِالَّذِينَ يَتْلُونَ عَلَيْهِمُ آيَاتِنَا ۗ قُلْ أَقَاتِبْكُمْ بِبَشَرٍ مِّنْ ذُرِّيَّتِكُمْ ۗ أَلَتَارُ ۗ وَعَدَهَا اللَّهُ الَّذِينَ كَفَرُوا ۗ وَبَشَرٍ

مِّنْ الْمَصِيرِ ﴿٢٣﴾



74. O njerëz! (Ju) jepet një shembull, dëgjojeni me vëmendje. Ata që ju i lusni në vend të Allahut, kurrë nuk do të krijojnë dot as (edhe) një mizë, edhe sikur të bashkohen për (ta bërë) këtë. Madje, nëse miza u rrëmben diçka, ata nuk mund ta rimarrin dot prej saj. Sa të dobët qenkan kërkuesi dhe i kërkuari!

يَا أَيُّهَا النَّاسُ ضُرِبَ مَثَلٌ فَاستَمِعُوا لَهُ ۗ  
 إِنَّ الَّذِينَ تَدْعُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ لَنْ يَخْلُقُوا  
 ذُبَابًا وَلَا يُجْتَمَعُوا لَهُ ۗ وَإِنْ يَسْلُبْهُمُ  
 الذُّبَابُ شَيْئًا لَا يَسْتَنْقِذُوهُ مِنْهُ ۗ ضَعُفَ  
 الطَّالِبُ وَالْمَطْلُوبُ ﴿٧٤﴾

75. Nuk e vlerësuan Allahun, siç duhej vlerësuar Ai. Sigurisht, Allahu është i Forti, i Plotfuqishmi.

مَا قَدَرُوا اللَّهَ حَقَّ قَدْرِهِ ۗ إِنَّ اللَّهَ لَقَوِيٌّ  
 عَزِيزٌ ﴿٧٥﴾

76. Allahu zgjedh të dërguar nga engjëjt dhe nga njerëzit. Sigurisht, Allahu është Gjithëdëgjues, Gjithëshikues.<sup>12</sup>

اللَّهُ يَصْطَفِي مِنَ الْمَلَائِكَةِ رُسُلًا وَمَنْ  
 النَّاسُ ۗ إِنَّ اللَّهَ سَمِيعٌ بَصِيرٌ ﴿٧٦﴾

77. Ai di gjithçka që është para tyre dhe gjithçka që është pas tyre. Dhe tek Allahu do të kthehen çështjet.

يَعْلَمُ مَا بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَمَا خَلْفَهُمْ ۗ وَإِلَى  
 اللَّهِ تُرْجَعُ الْأُمُورُ ﴿٧٧﴾

78. O ju që besuat! Përkuluni, bëni sexhde, adhuroni Zotin tuaj dhe bëni mirësi, që të keni sukses.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا ارْكَعُوا وَاسْجُدُوا  
 وَاعْبُدُوا رَبَّكُمْ وَافْعَلُوا الْخَيْرَ لَعَلَّكُمْ  
 تُفْلِحُونَ ﴿٧٨﴾

Sexhdeja VII

12. Ky ajlet tregon se është praktikë e vijueshme e Allahut t'u dërgojë engjëjt e Tij si të dërguar drejt robërve të Tij të sinqertë, po kështu është praktikë e vijueshme e Tij të zgjedhë si të dërguar prej njerëzve, sepse Ai dëgjon shumë lutjet dhe njeh mirë gjendjen e njerëzimit. Kurdo që një shpirt njerëzor do ta lypë ujin qiellor, Allahu do t'ia zbresë ujin atij, dhe kurdo që Allahu sheh se njerëzit po largohen nga besimi në Të, do të caktojë dikë nga robërit e Tij të sinqertë për t'i udhëzuar njerëzit. Konteksti tregon se në këto ajete Allahu i drejtohet popullit të Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, pra nuk është përmendur histori e ndonjë populli tjetër të mëparshëm. Ligjërimi i këtij ajeti është në kohën *mudari*, që në arabisht përfaqëson edhe kohën e tashme, edhe kohën e ardhme, dhe ajeti flet për çështjen e profetërisë dhe të dërgesës së shpalljes Hyjnore, andaj, provon që edhe në *umetin* e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, Allahu i Madhërishtëm do të caktojë disa shërbëtorë të sinqertë të fesë Islame, në gradën e profetit dhe të dërguarit. Në këtë ajlet, Allahu i Madhërishtëm tregoi praktikën e Tij si një parim, për të cilën nuk përmendet diku tjetër që do të ndërpritet, dhe kjo praktikë e Tij është që Ai gjithmonë zgjedh të dërguar të Tij prej engjëjve dhe prej njerëzve. Lexoni edhe 4:69-71; 33:41.

79. Dhe përpiquni fort në (rrugën e) Allahut, siç duhet përpjekur për Të. Ai ju zgjodhi dhe nuk bëri asnjë vështirësi për ju në fe. (Ndiqeni) fenë e babait tuaj, Ibrahimit. Ai (Allah) ju quajti muslimanë edhe para (kësaj), edhe në këtë (Kuran), që i Dërguari të jetë dëshmitar mbi ju dhe ju të jeni dëshmitarë mbi njerëzit. Andaj, falni namazin, jepni zekatin dhe kapeni fuqimisht Allahun. Ai është Mbrotjtësi juaj. Sa Mbrotjtës i mirë dhe sa Ndihmës i mirë është Ai!<sup>13</sup>

وَجَاهِدُوا فِي اللَّهِ حَقَّ جِهَادِهِ ۗ هُوَ  
اجْتَبَاكُمْ وَمَا جَعَلَ عَلَيْكُمْ فِي الدِّينِ مِنْ  
حَرَجٍ ۗ مِلَّةَ أَبِيكُمْ إِبْرَاهِيمَ ۗ هُوَ  
سَمُّكُمْ الْمُسْلِمِينَ ۗ مِنْ قَبْلُ وَفِي هَذَا  
لِيَكُونَ الرَّسُولُ شَهِيدًا عَلَيْكُمْ وَتَكُونُوا  
شُهَدَاءَ عَلَى النَّاسِ ۗ فَأَقِيمُوا الصَّلَاةَ وَآتُوا  
الزَّكَاةَ وَاعْتَصِمُوا بِاللَّهِ ۗ هُوَ مَوْلَاكُمْ ۗ  
بِئْسَ فِتْنَمَ الْمَوْلَىٰ وَنِعْمَ النَّصِيرُ ﴿٧٩﴾

13. Gjëja e parë që na tërheq vëmendjen ky ajet është që askush nga njerëzit nuk ka monopol fjalën “muslim” a “musliman” (lexoni edhe shpjegimin te 49:12). Edhe para se të vinte feja Islame, Allahu i Madhërishëm kishte quajtur “muslimanë” Ibrahimin dhe popullin e tij. Pas kësaj, thotë se Hazret Profeti Muhammed<sup>savs</sup> është dëshmitar ose mbikëqyrës mbi të gjithë muslimanët dhe se muslimanët janë dëshmitarë mbi të gjithë njerëzit. Ashtu siç i Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> kreu detyrën e të qenit dëshmitar gjatë jetës së tij, edhe muslimanët, duke e ndjekur atë, janë dëshmitarë për të tjerët. Pra, të jeni dëshmitarë, nuk do të thotë të bëni në tjerët muslimanë me zor si ta mendoni ju, sepse i Dërguari i Allahut<sup>savs</sup>, si një dëshmitar, asnjëherë nuk bëri luftë për këtë synim dhe as nuk bëri me zor musliman dikë tjetër.

## Surja 23 – El-Mu'minun

Surja El-Mu'minun është një ndër suret e fundit që zbritën në Mekë. Bashkë me *bismil-lahin* ajo ka njëqind e nëntëmbëdhjetë ajete.

Surja paraardhëse u mbyll me mesazhin që fitorja e vërtetë arrihet duke ngritur namazin e zekatin dhe duke u lidhur fuqimisht me Allahun e Madhërishëm. Pikërisht për këtë fitore shpjegohet me hollësi në fillim të sures El-Mu'minun. Besimtarët që do të triumfojnë janë ata, të cilët jo vetëm që e lartësojnë namazin dhe e japin zekatin, por stolisin veten me një sërë virtytesh, si në aspektin e frenimit nga të këqijat, ashtu edhe në aspektin e bërjes së veprave të mira.

Pas kësaj thuhet se uji i jetës edhe pse zbret prej qiellit dhe ekziston edhe sistemi që mundëson zbritjen e tij në mënyrë të përsëritur, prapëseprapë nëse Zoti i Madhërishëm për ndonjë arsye të caktuar, dëshiron t'u japë mësim njerëzve, Ai është i Plotfuqishëm ta kthejë atë. Kjo mund të ndodhë në dy mënyra: Zoti i Madhërishëm të ndryshojë sistemin e ciklit të ujit, siç ishte edhe në fillimet e krijimit të tokës, që, për shkak të nxehtësisë në atmosferë, uji që binte, avullohej përsëri pa rënë akoma në tokë. Situata e dytë është ajo që shohim edhe sot. Pra, uji shkon në një shtresë kaq të thellë në tokë, saqë nuk buron më prej saj.

Vijon tema e ujit. Surja përmend anije që lundrojnë mbi ujë dhe në këtë kontekst përmendet edhe arka e Nuhut<sup>as</sup>, duke thënë se edhe anijet mund të qëndrojnë mbi ujë vetëm me lejen e Allahut të Madhërishëm. Anijet nganjëherë kapërcejnë edhe dallgët më të mëdha dhe nganjëherë mbyten edhe në një furtunë të zakonshme.

Kur popujt tregohen mosmirënjohës ndaj ujit shpirtëror që u zbret prej qiellit, Zoti i Madhërishëm ua merr këtë ujë, siç merr edhe ujin fizik. Madje, në disa raste, njerëzit kalojnë në gjendje që atyre as nuk u bën më dobi edhe sikur t'u zbresë ujë shpirtëror në mënyrë të vijueshme. Të tillëve vazhdimisht u kanë ardhur të dërguarit, dhe ata vazhdimisht i kanë refuzuar.

Më pas flitet për një zonë malore, ku rrjedhin burime dhe qetësohet shpirti. Kjo sure thotë se pikërisht atje në rrafshnaltë, Zoti i Madhërishëm i mundësoi strehë *Hazret Isait*<sup>as</sup> dhe nënës së tij, duke i shpëtuar nga armiku. Shenjat dhe faktet tregojnë se kjo ishte pikërisht lugina e Kashmirit.

Në ajetin 79 thuhet se në etapat e evolucionit, aftësia e të dëgjuarit u zhvillua përpara se të vinte aftësia e të parit. Më pas, Zoti i mundësoi njeriut një zemër që ka edhe shikim të thellë shpirtëror dhe që është edhe e aftë të kuptojë të gjitha temat shpirtërore.

Më pas vijnë disa ajete, që kanë tema të ngjashme me ato që u shpjeguan edhe më parë. Pastaj përmendet një temë e re në një ajet, i cili thotë se Ditën e Gjykimit, kur njerëzit do të pyeten se sa kanë qëndruar në tokë, ata do të përgjigjen: Ndoshta një ditë ose vetëm një pjesë të ditës. Zoti i Madhërishëm u përgjigjet: Në të vërtetë ju

keni qëndruar atje edhe më pak se kaq. Realisht, kjo shpjegon kohën e gjatë që do të ketë periudha mes vdekjes dhe ringjalljes. Pra, jeta e kësaj bote do të bëhet kaq e largët, saqë njerëzve do t'u duket se ajo kaloi sa hap e mbyll sytë. Këtë mund ta kuptojmë nga përvoja jonë e përditshme. Shohim yje të largëta që duken si pika të vogla, por që janë shumë më të mëdha se dielli apo trupa të tjerë të sistemit diellor.

Ajeti i fundit i kësaj sureje i mëson një lutje Profetit Muhammed<sup>savs</sup>: “O Zoti im! Fal dhe mëshiro! Ti je Mëshiruesi më i mirë!”



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ۝

2. Sigurisht, fituan besimtarët;

۝ قَدْ أَفْلَحَ الْمُؤْمِنُونَ ۝

3. ata që janë të përvulur në namazin e tyre,

۝ الَّذِينَ هُمْ فِي صَلَاتِهِمْ خَشِعُونَ ۝

4. ata që i shmangen kotësisë,

۝ وَالَّذِينَ هُمْ عَنِ اللَّغْوِ مُعْرِضُونَ ۝

5. ata që japin zekatin,

۝ وَالَّذِينَ هُمْ لِلزَّكَاةِ فَجِلُونَ ۝

6. ata që ruajnë organet e tyre intime;

۝ وَالَّذِينَ هُمْ لِأَفْوَاجِهِمْ حَفِظُونَ ۝

7. përveçse me bashkëshortet e tyre ose me ato që i kanë në zotërim. Ata nuk do të qortohen,

۝ إِلَّا عَلَىٰ أَرْوَاجِهِمْ أَوْ مَا مَلَكَتْ أَيْمَانُهُمْ فَإِنَّهُمْ غَيْرُ مَلُومِينَ ۝

8. ata që kërkojnë përtej kësaj, pa dyshim janë shkelës;

۝ فَمَنْ ابْتغى وراءَ ذلك فأولئك هم العادون ۝

9. dhe (fituan) ata që i ruajnë amanetet dhe zotimet e tyre,

۝ وَالَّذِينَ هُمْ لِأَمْتِهِمْ وَعَهْدِهِمْ رِعُونَ ۝

10. ata që u rrinë roje namazeve të tyre.

۝ وَالَّذِينَ هُمْ عَلَىٰ صَلَوَاتِهِمْ يُحَافِظُونَ ۝

11. Pikërisht këta janë trashëguesit,

۝ أُولَٰئِكَ هُمُ الْوَارِثُونَ ۝

12. të cilët, do të trashëgojnë Firdeusin. Në të do të jetojnë përgjithmonë.

۝ الَّذِينَ يَرِثُونَ الْفِرْدَوْسَ هُمْ فِيهَا خَالِدُونَ ۝

13. Dhe sigurisht, Ne krijuam njeriun nga një esencë prej balte.

وَلَقَدْ خَلَقْنَا الْإِنْسَانَ مِنْ سُلَالَةٍ مِنْ طِينٍ ﴿١٣﴾

14. Më pas atë e bëmë spermë, në një vend të sigurt.

ثُمَّ جَعَلْنَاهُ نُطْفَةً فِي قَرَارٍ مَكِينٍ ﴿١٤﴾

15. Pastaj spermën e bëmë ngjizje gjaku, ngjizjen e gjakut e bëmë copëz mishi, copëzën e mishit e bëmë kocka dhe kockave iu veshëm mish. Më pas atë e bëmë një krijesë tjetër. Pra, vetëm Allahu zotëron bekimin, Krijuesi më i përsosur.

ثُمَّ خَلَقْنَا النُّطْفَةَ عَلَقَةً فَخَلَقْنَا الْعَلَقَةَ مُضْغَةً فَخَلَقْنَا الْمُضْغَةَ عِظْمًا فَكَسَوْنَا الْعِظْمَ لَحْمًا ثُمَّ أَنشَأْنَاهُ خَلْقًا آخَرَ ۗ فَتَبَارَكَ اللَّهُ أَحْسَنَ الْخَالِقِينَ ﴿١٥﴾

16. Pa dyshim, pas kësaj ju do të vdisni.

ثُمَّ إِنَّكُمْ بَعْدَ ذَلِكَ لَمَيِّتُونَ ﴿١٦﴾

17. Pas asaj, sigurisht, Ditën e Kiametit do të ngriheni sërish.

ثُمَّ إِنَّكُمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ تُبْعَثُونَ ﴿١٧﴾

18. Ne krijuam shtatë rrugë sipër jush dhe Ne nuk jemi të pavëmendshëm ndaj krijesës.<sup>1</sup>

وَلَقَدْ خَلَقْنَا فَوْقَكُمْ سَبْعَ طَرَائِقٍ ۗ وَمَا كُنَّا عَنِ الْخَلْقِ غَفِيلِينَ ﴿١٨﴾

19. Ne zbritëm prej qiellit ujë në masë të llogaritur dhe e bëmë të qëndrojnë në tokë dhe sigurisht, Ne jemi të Plotfuqishëm për ta larguar atë.

وَ أَنْزَلْنَا مِنَ السَّمَاءِ مَاءً بِقَدَرٍ فَأَسْكَنْتَهُ فِي الْأَرْضِ ۗ وَإِنَّا عَلَىٰ ذَهَابٍ بِهِ لَقَدِيرُونَ ﴿١٩﴾

20. Më pas, prej tij bëmë për ju kopshte hurmash dhe rrushi. Në to keni fruta të shumta dhe ju prej tyre hani.

فَأَنشَأْنَا لَكُمْ بِهِ جَنَّتٍ مِّنْ نَّحِيلٍ وَأَعْنَابٍ ۗ لَكُمْ فِيهَا فَوَاكِهٌ كَثِيرَةٌ وَمِنْهَا تَأْكُلُونَ ﴿٢٠﴾

1. Ky ajet flet për shtatë rrugë qiellore sipër njeriut. Në arabisht, numri shtatë ka edhe kuptimin e përsëritjes, siç për shembull, java që përsëritet pas çdo shtatë ditësh. Andaj, “shtatë rrugë” nënkuptojnë edhe rrugë të panumërta.

21. Dhe (bëmë) një pemë që del në malin e Sinaït, mbin e shoqëruar me vaj dhe një salcë për ata që hanë.

وَشَجَرَةً تَخْرُجُ مِنْ طُورِ سَيْنَاءَ تَنْثُرُتُ  
بِالذُّهْنِ وَصَبْغٍ لَّيْلًا كَلِيلًا ﴿٢١﴾

22. Sigurisht, edhe në bagëtitë ka mësim për ju. Ne ju japim për të pirë atë që ka në barqet e tyre dhe në to keni edhe përfitime të tjera të shumta dhe po prej tyre edhe ushqeheni.

وَإِنَّ لَكُمْ فِي الْأَنْعَامِ لَعِبْرَةً ۖ نُسْقِيكُمْ مِمَّا  
فِي بُطُونِهَا وَلَكُمْ فِيهَا مَنَافِعُ كَثِيرَةٌ وَمِنْهَا  
تَأْكُلُونَ ﴿٢٢﴾

23. Në to dhe në anije ju udhëtoni.

عَلَىٰ وَعَلَيْهَا وَعَلَى الْفُلْكِ تُحْمَلُونَ ﴿٢٣﴾

24. Ne i dërguam Nuhun popullit të tij dhe ai tha: “O populli im! Adhuroni Allahun; nuk keni ndonjë të adhurueshëm tjetër përveç Atij. A nuk druheni?!”

وَلَقَدْ أَرْسَلْنَا نُوحًا إِلَىٰ قَوْمِهِ فَقَالَ يٰقَوْمِ  
اعْبُدُوا اللَّهَ مَا لَكُمْ مِنْ إِلَهٍ غَيْرُهُ ۖ أَفَلَا  
تَتَّقُونَ ﴿٢٤﴾

25. Prijësit e popullit të tij që mohuan thanë: “Ky qenka vetëm njeri sikur ju, (që) dëshiron të ketë epërsi mbi ju. Po të donte Allahu, do të zbriste engjëj. Në (historitë) e baballarëve tanë të parë, ne nuk kemi dëgjuar për këtë.

فَقَالَ الْمَلَأُ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ قَوْمِهِ مَا هَذَا  
إِلَّا بَشَرٌ مِّثْلُكُمْ ۗ يُرِيدُ أَنْ يَتَفَضَّلَ  
عَلَيْكُمْ ۗ وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ لَأَنْزَلَ مَلَائِكَةً ۚ مَا  
سَمِعْنَا بِهَذَا فِي آبَائِنَا الْأَوَّلِينَ ﴿٢٥﴾

26. Ai është thjesht një njeri që e ka zënë xhindi. Prandaj, prisni për (fundin e) tij për një kohë.”

إِنْ هُوَ إِلَّا رَجُلٌ بِهِ جِنَّةٌ فَبَرَبِّصُوا بِهِ حَتَّىٰ  
حِثِّينَ ﴿٢٦﴾

27. (Nuhu) tha: “O Zoti im! Më ndihmo sepse më quajtën gënjeshtar!”

قَالَ رَبِّ انصُرْنِي بِمَا كَذَّبُونِ ﴿٢٧﴾

28. Atëherë Ne i shpallëm: Ndërto anijen përpara syve Tanë dhe sipas shpalljes Sonë; dhe kur të vijë urdhri Ynë dhe të gufojë burimi (i tokës), hip në të çiftin e secilës (kafshe të nevojshme), gjithashtu edhe familjen

فَأَوْحَيْنَا إِلَيْهِ أَنْ اصْنَعْ الْفُلَ بِأَعْيُنِنَا  
وَوَحِينَا فَإِذَا جَاءَ أَمْرُنَا وَفَارَ التَّنُّورُ  
فَأَسْلُكْ فِيهَا مِنْ كُلِّ زَوْجَيْنِ اثْنَيْنِ

tënde, me përjashtim të atij prej tyre, kundër të cilit u lëshua vendimi. Dhe mos fol me Mua për ata që janë keqbërës. Ata do të fundosen patjetër.

29. Kur ti dhe shoqëruesit e tu të vendosen në anije, thuaj: “Lavdia është e Allahut që na shpëtoi nga populli keqbërës!”

30. Dhe thuaj: “O Zoti im! Më zbarko në një vend të bekuar dhe Ti je zbarkuesi më i mirë!”

31. Sigurisht, në këtë ka shenja dhe sigurisht Jemi Ne që sprovovjmë (njerëzit).

32. Mandej pas tyre, Ne krijuam njerëzit e një epoke tjetër.

33. Edhe atyre u dërguam një të dërguar nga gjiri i tyre, që (u thoshte): “Adhuroni Allahun; nuk keni ndonjë të adhurueshëm tjetër përveç Atij. A nuk druheni?!”

34. Prijësit e popullit të tij që mohuan dhe e quajtën gënjeshtër takimin e *ahiretit* dhe të cilët Ne i kishim begatuar në jetën e kësaj bote, thanë: “Ky qenka vetëm njeri sikur ju, (që) ushqehet nga ajo që ushqeheni edhe ju, dhe pi atë që pini edhe ju!

35. Dhe po t'i bindeni një njeriu sikur ju, përnjëmend do të jeni humbës!

وَأَهْلَكَ إِلَّا مَنْ سَبَقَ عَلَيْهِ الْقَوْلُ مِنْهُمْ ۗ  
وَلَا تُخَاطَبُنِي فِي الَّذِينَ ظَلَمُوا ۗ إِنَّهُمْ  
مُغْرَقُونَ ﴿٢٩﴾

فَإِذَا اسْتَوَيْتَ أَنْتَ وَمَنْ مَعَكَ عَلَى الْفُلِكِ  
فَقُلِ الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي نَجَّيْنَا مِنَ الْقَوْمِ  
الظَّالِمِينَ ﴿٣٠﴾  
وَقُلِ رَبِّ أَنْزِلْنِي مُنْزَلًا مُبْرَكًا وَأَنْتَ خَيْرُ  
الْمُنْزِلِينَ ﴿٣١﴾

إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ وَإِن كُنَّا لَمُبْتَلِينَ ﴿٣٢﴾

ثُمَّ أَنْشَأْنَا مِنْ بَعْدِهِمْ قَرْنًا آخَرِينَ ﴿٣٣﴾

فَأَرْسَلْنَا فِيهِمْ رَسُولًا مِنْهُمْ أَنْ اعْبُدُوا  
اللَّهَ مَا لَكُمْ مِنْ آلِهَةٍ غَيْرُهُ ۗ أَفَلَا تَتَّقُونَ ﴿٣٤﴾

وَقَالَ الْمَلَأُ مِنْ قَوْمِهِ الَّذِينَ كَفَرُوا  
وَكَذَّبُوا بِلِقَاءِ الْآخِرَةِ وَأَتْرَفَهُمْ فِي الْحَيَاةِ  
الدُّنْيَا ۗ مَا هَذَا إِلَّا بَشَرٌ مِثْلُكُمْ ۗ لَا يَأْكُلُ مِمَّا  
تَأْكُلُونَ مِنْهُ وَيَشْرَبُ مِمَّا تَشْرَبُونَ ﴿٣٥﴾

وَلَكِنْ أَطَعْتُمْ بَشَرًا مِثْلَكُمْ ۗ إِنَّكُمْ إِذًا  
لَخٰسِرُونَ ﴿٣٦﴾



36. A ju paralajmëron ai që kur të vdisni dhe të bëheni pluhur dhe eshtra, do të nxirreni (të gjallë) sërish?!

أَيُّدِكُمْ أَنْكُمْ إِذَا مِتُّمْ وَكُنْتُمْ تُرَابًا  
وَعِظَامًا أَنْكُمْ مُخْرَجُونَ ﴿٣٦﴾

37. Larg, shumë larg nga realiteti ajo që ju paralajmërohet!

هِيَاهُتَ هِيَاهُتَ لِمَا تُوْعَدُونَ ﴿٣٧﴾

38. Jeta jonë është vetëm kjo e kësaj bote. Ne edhe vdesim, edhe jetojmë por kurrsesi nuk do të ringjallemi.

إِنْ هِيَ إِلَّا حَيَاتُنَا الدُّنْيَا نَمُوتُ وَنَحْيَا وَمَا  
نَحْنُ بِمَبْعُوثِينَ ﴿٣٨﴾

39. Ky është thjesht një njeri që trilloi gënjeshtër mbi Allahun dhe ne nuk kemi për t'i besuar atij.”

إِنْ هُوَ إِلَّا رَجُلٌ افْتَرَىٰ عَلَى اللَّهِ كَذِبًا  
وَمَا نَحْنُ لَهُ بِمُؤْمِنِينَ ﴿٣٩﴾

40. (I Dërguari) tha: “O Zoti im! Më ndihmo sepse më quajtën gënjeshtar!”

قَالَ رَبِّ انصُرْنِي بِمَا كَذَّبُونَ ﴿٤٠﴾

41. (Zoti i) tha: “Shumë shpejt ata do të mbeten të penduar.”

قَالَ عَمَّا قَلِيلٍ لَيُصْبِحُنَّ نَادِمِينَ ﴿٤١﴾

42. Atëherë i zuri krisma me të drejtë dhe Ne i bëmë mbeturina. U shkatërroftë populli keqbërës!

فَأَخَذْتَهُمُ الصَّيْحَةَ بِالْحَقِّ فَعَبَّلَهُمْ غُثَاءً  
فَبَعَدَ اللّٰهُمُ الظّٰلِمِينَ ﴿٤٢﴾

43. Pas tyre krijuam brezni të tjera.

ثُمَّ أَنْشَأْنَا مِنْ بَعْدِهِمْ قَرُونًا آخَرِينَ ﴿٤٣﴾

44. Asnjë popull nuk mund ta tejkalojë afatin e vet dhe as nuk mund të mbetet mbrapa.

مَا تَسْبِقُ مِنْ أُمَّةٍ أَجَلَهَا وَمَا يَسْتَأْخِرُونَ ﴿٤٤﴾

45. Më pas dërguam të Dërguarit Tanë njërin pas tjetrit. Kurdoherë që i erdhi ndonjë populli i Dërguari i tij, ata e quajtën gënjeshtar. Atëherë Ne bëmë që disa prej tyre të ndiqnin disa të tjerë dhe ata i bëmë histori të së kaluarës. U shkatërroftë populli që nuk beson!

ثُمَّ أَرْسَلْنَا رُسُلَنَا تَتْرًا ۖ كُلَّمَا جَاءَ أُمَّةً  
رَّسُولُهَا كَذَّبُوهُ فَاتَّبَعْنَا بَعْضَهُمْ بَعْضًا  
وَجَعَلْنَاهُمْ أَحَادِيثَ ۖ فَبَعَدَ اللّٰهُمُ  
يَوْمَئِذٍ ﴿٤٥﴾

46. Më pas dërguam Musain dhe vëllanë e tij Harunin, me shenjat Tona dhe me argument të qartë;

ثُمَّ أَرْسَلْنَا مُوسَىٰ وَ أَخَاهُ هَارُونَ بِآيَاتِنَا  
وَسُلْطٰنٍ مُّبِينٍ ﴿٤٦﴾

47. drejt Faraonit dhe parisë së tij. Ata u treguan arrogantë. Ishin një popull rebel.

إِلَىٰ فِرْعَوْنَ وَمَلَئِهِ فَاسْتَكْبَرُوا وَكَانُوا  
قَوْمًا عَالِينَ ﴿٤٧﴾

48. Pra, thanë: “A t’u besojmë dy njerëzve si ne, ndërkohë populli i tyre na janë skllëvër.”

فَقَالُوا أَنُؤْمِنُ لِبَشَرَيْنِ مِثْلِنَا وَقَوْمُهُمَا  
لَنَا عِبْدُونَ ﴿٤٨﴾

49. Ata i quajtën gënjeshtarë (Musain dhe Harunin) dhe u bënë prej atyre që shkatërrohen.

فَكَذَّبُوهُمَا فَكَانُوا مِنَ الْمُهْلَكِينَ ﴿٤٩﴾

50. Sigurisht, Ne i kishim dhënë Musait Librin që ata të udhëzoheshin.

وَلَقَدْ آتَيْنَا مُوسَىٰ الْكِتَابَ لَعَلَّهُمْ يَهْتَدُونَ ﴿٥٠﴾

51. Birin e Merjemes si dhe nënën e tij Ne i bëmë shenjë dhe të dy i strehuam në një rrafshnaltë të qetë dhe plot me burime.<sup>2</sup>

وَجَعَلْنَا ابْنَ مَرْيَمَ وَأُمَّهُ آيَةً وَ آوَيْنَاهُمَا  
إِلَىٰ رَبْوَةٍ ذَاتِ قَرَارٍ وَمَعِينٍ ﴿٥١﴾

2. Kurani, Bibla dhe fakte historike mbështesin fuqimisht pikëpamjen se Jezusi (Hazret Isai<sup>as</sup>) nuk vdiq në kryq. (Lexoni 4:158-159; 5:111; 3:55). Një nga misionet kryesore të Jezusit ishte të mblidhte fiset e humbura të Izraelit në vathën e Bariut të madh, siç thotë ai vetë: “Unë kam edhe dele të tjera që nuk janë të kësaj vathe; duhet t’i mbledh edhe ato, dhe ato do ta dëgjojnë zërin tim, dhe do të jetë një tufë e vetme dhe një Bari i vetëm.” (Gjoni 10:16). Këto “dele të humbura”, pas dëbimit të tyre në mënyrë masive nga asirianët dhe babilonasit, kishin jetuar në Irak dhe Iran; dhe më vonë, kur iranianët nën Darin dhe Kirin, zgjeruan territoret e tyre më në Lindje deri në Afganistan dhe Indi, këto fise imigruan me ta në këto vende. Prandaj, popujt e Kashmirit dhe të Afganistanit janë pasardhës të “deleve të humbura” izraelite. Ky fakt është mjaft i dukshëm edhe në traditat, toponimet dhe në dorëshkrimet e këtyre dy popujve. Toponimet, emrat e fiseve, zakonet, mënyra e jetesës, veshja, tiparet e tyre fizike, etj., të gjitha ngjajnë me ato të hebrenjve. Edhe monumentet e tyre të lashta dhe mbishkrimet e vjetra e mbështesin këtë pikëpamje. Folklori i tyre është plot me histori hebreje. Vetë emri *kashmir* është në të vërtetë *kashir* që do të thotë *si Siria* (ose duket se është emëruar nga *Kushi* ose *Kashi*, nipi i Noeut). Përveç kësaj, gjatë jetës së Jezusit<sup>as</sup>, nuk kishte asnjë ngjarje të atillë, kur ai dhe nëna e tij të detyroheshin të strehoheshin, përveç pas ngjarjes së kryqëzimit. Prandaj vendstrehimi i cilësuar nga Kurani si “një rrafshnaltë e qetë dhe plot me burime” nënkupton Kashmirin, ku Jezusi<sup>as</sup> mërgoi për të kaluar pjesën tjetër të jetës dhe aty ndërroi jetë. Varr i tij është në lagjen Khanjar (Khanyar), Srinagar, të Kashmirit. Ky varr që quhet *Rozabal*, njihet

52. O të dërguar! Hani nga gjërat e pastra dhe bëni të mira. Unë, pa dyshim, jam i Gjithëdijshëm për atë që bëni.<sup>3</sup>

يَا أَيُّهَا الرُّسُلُ كُلُّوْا مِنَ الطَّيِّبَاتِ وَاعْمَلُوا صَالِحًا إِنِّي بِمَا تَعْمَلُونَ عَلِيمٌ ۝٥٢

53. Ky është populli juaj, një popull i vetëm dhe Unë jam Zoti juaj, andaj, prej Meje kini druajtje.<sup>4</sup>

وَإِنَّ هَذِهِ أُمَّتُكُمْ أُمَّةً وَاحِدَةً وَأَنَا رَبُّكُمْ فَاتَّقُونِ ۝٥٣

54. Më pas ata e copëtuan dhe e ndanë çështjen (pra, Sheriatin) e tyre mes vete. Çdo grup filloi të mburrej me atë që kishte.

فَتَقَطَّعُوا أَمْرَهُمْ بَيْنَهُمْ زُبُرًا ط كُلِّ حِزْبٍ بِمَا لَدَيْهِمْ فَرِحُونَ ۝٥٤

55. Andaj, lëri në injorancën e tyre deri në një kohë.

فَذَرَهُمْ فِي عَمْرَتِهِمْ حَتَّىٰ حِينٍ ۝٥٥

56. A mendojnë ata se Ne po i shtojmë në pasuri dhe pasardhës,

أَيَحْسَبُونَ أَنَّمَا نُمِدُّهُمْ بِهِ مِنْ مَّالٍ وَبَيْنٍ ۝٥٦

57. që t'i nxisim në mirësi?! Përkundrazi, ata nuk kuptojnë.

نَسَارِعُ لَهُمْ فِي الْخَيْرَاتِ ط بَلْ لَا يَشْعُرُونَ ۝٥٧

ndryshe si varri i *Juz Asafit* (Yuz Asaf), i *Profetit të nderuar* (Nabi Sahib), i *Profetit princ* (Shahzadah Nabi) dhe madje edhe si i *Isait të nderuar* (Isa Sahib). Sipas fakteve të vërtetuara, Juz Asafi u vendos në Kashmir 1900 vjet më parë, ku predikonte në gjuhë të figurshme, siç është gjuha e tij edhe në Ungjij. Për një studim më të plotë për çështjen në fjalë, lexoni librin “Mesihu në Indi” të shkruar nga *Hazret Mirza Ghulam Ahmed*<sup>as</sup>, Themeluesi i Xhematit Musliman Ahmedia.

3. Pjesa e parë e porosisë që mban ky ajet lidhet me shëndetin trupor, siç thotë: “hani nga gjërat e pastra”, kurse pjesa e dytë me shëndetin shpirtëror, që thotë “bëni të mira”. Lidhja e të dyja porosive tregon se ushqimi ndikon në gjendjen shpirtërore dhe, së dyti, tregon se ndëshkimi i njeriut në botën tjetër për veprat e tij të këqija është një nevojë shpirtërore, sepse ashtu siç në këtë botë kur e prishim rregullën e të ushqyerit, menjëherë sëmurimi ose trupi nuk ndihet mirë, në të njëjtën mënyrë, kur nuk zbatojmë parimin e shëndetit shpirtëror, do të na zërë një pasojë e dhimbshme në botën tjetër, e cila do të jetë rrjedhojë e veprave tona. (Lexoni edhe 7:32 dhe 23:101).

4. Të gjithë të Dërguarit e Zotit formojnë një vëllazëri, sepse ata erdhën nga e njëjta vatrë Hyjnore dhe se mësimet e tyre themelore ishin thuajse identike, po kështu edhe qëllimi i ardhjes së tyre ka qenë i njëjtë, pra të vendosnin Njëshmërinë e Zotit në tokë dhe të bashkonin njerëzit.

58. Ata që frikësohen nga ndikimi i Zotit të tyre,

إِنَّ الَّذِينَ هُمْ مِنْ خَشْيَةِ رَبِّهِمْ مُشْفِقُونَ ﴿٥٨﴾

59. që besojnë në ajetet e Zotit të tyre

وَالَّذِينَ هُمْ بِآيَاتِ رَبِّهِمْ يُؤْمِنُونَ ﴿٥٩﴾

60. që nuk bëjnë dikë ortak me Zotin e tyre

وَالَّذِينَ هُمْ بِرَبِّهِمْ لَا يُشْرِكُونَ ﴿٦٠﴾

61. që gjithçka që japin, e japin duke pasur frikë në zemër se ata kanë për t'u kthyer te Zoti i tyre;

وَالَّذِينَ يُؤْتُونَ مَا آتَوْا وَقُلُوبُهُمْ وَجِلَةٌ أَنَّهُمْ إِلَىٰ رَبِّهِمْ رَاجِعُونَ ﴿٦١﴾

62. pikërisht këta nxitojnë në mirësi dhe ata do të parakalojnë.

أُولَٰئِكَ يُسْرِعُونَ فِي الْخَيْرَاتِ وَهُمْ لَهَا سَابِقُونَ ﴿٦٢﴾

63. Ne nuk ngarkojmë asnjë shpirt përtej kapacitetit të tij dhe Ne kemi Libër që flet të vërtetën dhe atyre nuk do t'u bëhet padrejtësi.

وَلَا نُكَلِّفُ نَفْسًا إِلَّا وُسْعَهَا وَلَدَيْنَا كِتَابٌ يَبْطِقُ بِالْحَقِّ وَهُمْ لَا يُظْلَمُونَ ﴿٦٣﴾

64. E vërteta është që zemrat e tyre janë në shkujdesje ndaj tij dhe përveç kësaj, ata kanë edhe vepra të tjera që bëjnë.

بَلْ قُلُوبُهُمْ فِي غَمْرَةٍ مِنْ هَذَا وَلَهُمْ أَعْمَالٌ مِنْ دُونِ ذَلِكَ هُمْ لَهَا عَامِلُونَ ﴿٦٤﴾

65. Derisa kur i zëmë pasanikët e tyre përmes ndëshkimit, papritmas ata fillojnë të ulërijnë.

حَتَّىٰ إِذَا أَخَذْنَا مُتْرَفِيهِمْ بِالْعَذَابِ إِذَا هُمْ يَجْرُونَ ﴿٦٥﴾

66. “Sot mos ulërin! Juve nuk do t’ju jepet asnjë ndihmë nga Ne.

لَا تَجْرُوا الْيَوْمَ إِنَّكُمْ مِنَّا لَا تَنْصُرُونَ ﴿٦٦﴾

67. Ju lexoheshin ajetet e Mia, kurse ju i shmangnit duke i kthyer shpinën,

قَدْ كَانَتْ آيَاتِي تُتلىٰ عَلَيْكُمْ فَكُنْتُمْ عَلَىٰ أَعْقَابِكُمْ تَنْكِبُونَ ﴿٦٧﴾

68. duke u mburrur (dhe më pas) duke bërë diskutime të kota rreth tyre gjatë netëve.”

مُسْتَكْبِرِينَ ۖ بِهِ سِمِرًا تَهَجَّرُونَ ﴿٦٨﴾

69. A nuk e menduan fjalën apo u ka ardhur diçka që nuk u kishte ardhur baballarëve të tyre të parë?!

أَفَلَمْ يَدَّبَّرُوا الْقَوْلَ أَمْ جَاءَهُمْ مَا لَمْ  
يَأْتِ آبَاءَهُمُ الْأَوَّلِينَ ﴿٦٩﴾

70. Apo nuk e njohën të Dërguarin e tyre dhe prandaj po e mohojnë?!

أَمْ لَمْ يَعْرِفُوا رَسُولَهُمْ فَهُمْ لَهُ مُنْكَرُونَ ﴿٧٠﴾

71. Apo thonë se është i çmendur?! Përkundrazi, ai u erdhi me të vërtetën dhe shumica prej tyre nuk e pëlqejnë të vërtetën.

أَمْ يَقُولُونَ بِهِ جِنَّةٌ بَلْ جَاءَهُمُ بِالْحَقِّ  
وَكَثُرَهُمُ لِلْحَقِّ كِرْهُونَ ﴿٧١﴾

72. E po t'i ndiqte e vërteta dëshirat e tyre, do të çrregulloheshin qiejt, toka dhe kushdo që gjendet në to. E vërteta është që Ne atyre (njerëzve) ua sollëm përkujtimin e tyre, kurse ata pikërisht nga përkujtimi i tyre po shmangen.

وَلَوْ اتَّبَعَ الْحَقُّ أَهْوَاءَهُمْ لَفَسَدَتِ السَّمَوَاتُ  
وَالْأَرْضُ وَمَنْ فِيهِنَّ بَلْ أَتَيْنَهُمْ بِذِكْرِهِمْ  
فَهُمْ عَنِ ذِكْرِهِمْ مُعْرِضُونَ ﴿٧٢﴾

73. Vallë, ti a u kërkon atyre ndonjë shpërblim?! Atëherë (le ta dinë se) shpërblimi prej Zotit tënd është më i miri dhe Ai është Furnizuesi më i mirë.

أَمْ تَسْأَلُهُمْ خَرْجًا فَخَرَاجُ رَبِّكَ خَيْرٌ  
وَهُوَ خَيْرُ الرَّزَاقِينَ ﴿٧٣﴾

74. Pa dyshim, ti po i thërret ata në një rrugë të drejtë.

﴿٧٤﴾ وَإِنَّكَ لَتَدْعُوهُمْ إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ ﴿٧٤﴾

75. Kurse ata që nuk besojnë në *ahiret*, patjetër do të devijojnë nga rruga.

وَإِنَّ الَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ بِالْآخِرَةِ عَنِ  
الصِّرَاطِ لَنُكِبُونَ ﴿٧٥﴾

76. Nëse do t'i mëshironim dhe do t'ua largonim shqetësimin që kanë, ata do të vërtiteshin në tërbimin e tyre.

وَلَوْ رَحِمْنَاهُمْ وَكَشَفْنَا مَا بِهِمْ مِنْ ضُرٍّ لَلَجُّوا  
فِي طُعْيَانِهِمْ يَعْمَهُونَ ﴿٧٦﴾

77. Ne i zumë përmes ndëshkimit, sërish ata nuk iu përvulën Zotit të tyre. Dhe ata nuk përgjroheshin.

وَلَقَدْ أَخَذْنَاهُمْ بِالْعَذَابِ فَمَا اسْتَكَانُوا  
لِرَبِّهِمْ وَمَا يَتَضَرَّعُونَ ﴿٧٧﴾

78. E kur Ne u hapëm portën e një ndëshkimi të fuqishëm, ata papritmas mbetën të pashpresë.

حَتَّىٰ إِذَا فَتَحْنَا عَلَيْهِمُ بَابًا ذَا عَذَابٍ شَدِيدٍ  
إِذَا هُمْ فِيهِ مُبْلِسُونَ ﴿٧٨﴾

79. Është Ai që krijoi për ju dëgjimin, shikimin dhe zemrën. Sa pak që falënderoni!

وَهُوَ الَّذِي أَنشَأَكُمُ السَّمْعَ وَالْأَبْصَارَ  
وَالْأَفْئِدَةَ ۗ قَلِيلًا مَّا تَشْكُرُونَ ﴿٧٩﴾

80. Është Ai që ju krijoi në tokë dhe po tek Ai ju do të mblidheni.

وَهُوَ الَّذِي ذَرَأَكُمْ فِي الْأَرْضِ وَإِلَيْهِ  
تُحْشَرُونَ ﴿٨٠﴾

81. Është Ai që ju jep jetë dhe ju shkakton vdekje dhe i Atij është ndërrimi i natës dhe i ditës. A nuk logjikoni?!

وَهُوَ الَّذِي يُحْيِي وَيُمِيتُ وَلَهُ اخْتِلَافُ اللَّيْلِ  
وَالنَّهَارِ ۗ أَفَلَا تَعْقِلُونَ ﴿٨١﴾

82. Përkundrazi, ata thanë njësoj siç thanë të parët.

بَلْ قَالُوا مِثْلَ مَا قَالَ الْأَوَّلُونَ ﴿٨٢﴾

83. Ata thanë: “Kur do të vdesim e do të bëhemi pluhur dhe eshtra, a do të ringjallemi prapë?!”

قَالُوا ۗ إِذَا مِنَّا وَكُنَّا تُرَابًا وَ عِظَامًا  
ۗ إِنَّا لَمَبْعُوثُونَ ﴿٨٣﴾

84. Këtë na e kanë premtuar neve dhe edhe baballarëve tanë më parë. Po, këto janë përrallat e të parëve!”

لَقَدْ وَعَدْنَا نَحْنُ وَآبَاؤُنَا هَذَا مِنْ قَبْلُ ۖ إِن  
هَذَا إِلَّا آسَاطِيرُ الْأَوَّلِينَ ﴿٨٤﴾

85. Thuaju: E kujt është toka dhe gjithçka që gjendet në të? (Tregomëni) nëse e dini.

قُلْ لِمَنِ الْأَرْضُ وَمَنْ فِيهَا ۖ إِن كُنْتُمْ  
تَعْلَمُونَ ﴿٨٥﴾

86. Ata do të thonë: “Të Allahut janë.” Thuaju: Atëherë, a nuk pranoni këshillën?!

سَيَقُولُونَ لِلَّهِ ۗ قُلْ أَفَلَا تَذَكَّرُونَ ﴿٨٦﴾

87. Thuaju: Kush është Zoti i të shtatë qiejve dhe Zoti i Fronit madhështor?

قُلْ مَنْ رَبُّ السَّمَوَاتِ السَّبْعِ وَرَبُّ الْعَرْشِ  
الْعَظِيمِ ﴿٨٧﴾

88. Ata do të thonë: “(Këto janë) të Allahut.” Thuaju: A nuk druheni?!

سَيَقُولُونَ لِلّٰهِ أَفَلَا تَتَّقُونَ ﴿٨٨﴾

89. Thuaju: Kush është Ai, në dorën e të cilit është sundimi i çdo gjëje dhe i cili strehon dhe nuk jepet strehë përballë Tij, në qoftë se e dini?!

قُلْ مَنْ مِّنْ بِيَدِهِ مَلَكُوتُ كُلِّ شَيْءٍ وَهُوَ يُجِيرُ  
وَلَا يُجَارُ عَلَيْهِ إِنْ كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ ﴿٨٩﴾

90. Ata do të thonë: “(Në dorë) të Allahut.” Thuaju: Atëherë ku po mashtroheni?!

سَيَقُولُونَ لِلّٰهِ قُلْ فَأَلَيْ تَسْحَرُونَ ﴿٩٠﴾

91. E vërteta është që Ne atyre ua sollëm të vërtetën, kurse ata janë gënjeshtarë.

بَلْ آتَيْنَهُم بِالْحَقِّ وَإِنَّهُمْ لَكَاذِبُونَ ﴿٩١﴾

92. Allahu nuk mori ndonjë bir dhe as nuk ka ndonjë të adhurueshëm tjetër me Të. Po të ishte kështu, çdo i adhurueshëm do të veçohet duke marrë atë që krijoi dhe ata do të rebeloheshin kundër njëri-tjetrit. I Pastër është Allahu nga ajo që ata përshkruajnë.

مَا اتَّخَذَ اللّٰهُ مِنْ وَّلَدٍ وَ مَا كَانَ مَعَهُ مِنْ  
إِلٰهٍ إِذًا لَّذَهَبَ كُلُّ الْإِلٰهِ بِمَا خَلَقَ وَلَعَلَّ بَعْضُهُمْ  
عَلَىٰ بَعْضٍ سُبْحٰنَ اللّٰهِ عَمَّا يُصِفُونَ ﴿٩٢﴾

93. I Dijshmi i së padukshmes dhe i së dukshmes dhe është shumë i lartë nga gjithçka që ata e bëjnë ortak me Të.

عَلِيمِ الْغَيْبِ وَالشَّهَادَةِ فَتَعٰلَىٰ عَمَّا يُشْرِكُونَ ﴿٩٣﴾

94. Thuaj: “O Zoti im! Nëse më tregon atë për të cilën ata paralajmërohen,

قُلْ رَبِّ إِمَّا تُرِيْنِي مَا يُوعَدُونَ ﴿٩٤﴾

95. atëherë, o Zoti im, mos më lërë te populli keqbërës!”

رَبِّ فَلَا تَجْعَلْنِي فِي الْقَوْمِ الظَّالِمِينَ ﴿٩٥﴾

96. Sigurisht, Ne jemi të Plotfuqishëm për të ta treguar atë për të cilën i kemi paralajmëruar.

وَإِنَّا عَلٰىٰ أَنْ تُرِيَكَ مَا نَعِدُهُمْ لَقَدِيرُونَ ﴿٩٦﴾

97. Largo të keqen me atë (mënyrë) që është më e mira. Ne e dimë më së miri atë që ata përshkruajnë.

إِدْفَعِ بِالنِّتْيِ هِيَ أَحْسَنُ السَّبِيَّةِ ۖ نَحْنُ أَعْلَمُ  
بِمَا يَصِفُونَ ﴿٧٧﴾

98. Dhe thuaj: “O Zoti im! Kërkoj mbrojtjen Tënde nga nxitjet e djajve.

وَقُلْ رَبِّ أَعُوذُ بِكَ مِنْ هَمَزَاتِ الشَّيْطَانِ ﴿٧٨﴾

99. Më mbro, o Zoti im, që ata të mos më afrohen!”

وَأَعُوذُ بِكَ رَبِّ أَنْ يَحْضُرُونِ ﴿٧٩﴾

100. Vetëm kur dikujt prej tyre i vjen vdekja, thotë: “O Zoti im! Më kthe,

حَتَّىٰ إِذَا جَاءَ أَحَدَهُمُ الْمَوْتُ قَالَ رَبِّ ارْجِعُونِ ﴿٨٠﴾

101. ndoshta mund të bëj të mira në atë (botë) që e lashë.” Kurrsesi! Kjo që thotë ai është vetëm fjalë goje. Dhe mbrapa tyre ka pengesë<sup>5</sup> deri në ditën kur do të ringjallen ata.

لَعَلِّي أَعْمَلُ صَالِحًا فِيمَا تَرَكْتُ كَلَّا ۗ  
إِنَّهَا كَلِمَةٌ هُوَ قَائِلُهَا ۖ وَمِنْ وَرَائِهِمْ بَرْزَخٌ  
إِلَىٰ يَوْمٍ يُبْعَثُونَ ﴿٨١﴾

102. E kur do t'i fryhet bririt, atë ditë nuk do të kenë më ndonjë lidhje farefisnore mes tyre dhe as nuk do pyesin dot njëri-tjetrin.

فَإِذَا نُفِخَ فِي الصُّورِ فَلَا أَنْسَابَ بَيْنَهُمْ  
يَوْمَئِذٍ وَلَا يَتَسَاءَلُونَ ﴿٨٢﴾

5. Bota e dytë është bota e berzahut. Në të vërtetë, *berzah* në gjuhën arabe i thonë asaj që vjen mes dy gjërave, pra e *ndërmjetme*. Dhe ngaqë gjendet mes botës së parë dhe botës së ringjalljes, kjo periudhë quhet *berzah*. *Berzah* është fjalë arabe, e përbërë nga *zekh-kha* dhe *berra* dhe që do të thotë se ka mbaruar rruga për të fituar përmes veprave dhe njeriu ka kaluar në një gjendje të fshehtë. Berzahu fillon kur shpërbëhet qenia e vdekshme e njeriut dhe ndahen trupi dhe shpirti. Dhe siç e shohim që trupi i tij groposet, në të njëjtën mënyrë edhe shpirti i tij hidhet në një lloj grope. Këtë e tregon fjala *zekh-kha*, pra shpirti nuk ka më aftësi për të bërë mirë apo keq, gjë që bënte derisa ishte i lidhur me trupin. Ne dimë që shëndeti i shpirtit tonë varet nga shëndeti i trupit. Për shembull, nëse truri i njeriut pëson goditje në një pjesë të caktuar, ka mundësi që ai të humbë kujtesën, të humbë aftësinë për të menduar ose të humbë ndjenjat. Pavarësisht se trupi i vdekshëm ndahet nga shpirti pas vdekjes, në botën e berzahut, i jepet përkohësisht një trup, që të shijojë deri diku rezultatet e veprave të tij. Ky trup nuk është si i pari, por përgatitet prej një drite ose një errësire, në varësi të gjendjes së veprave. Me një fjalë, vetë gjendja e veprave të njeriut përbën një trup për të. Kjo pikërisht përmendet në Kuran, ku disa trupa janë quajtur prej drite e disa të tjerë prej errësire, që do të thotë se ata përgatiten nga drita e veprave ose nga errësira e tyre. Ky sekret duket shumë i fshehtë, por jo kundër logjikës.



103. Atëherë, ata të cilëve do t'u rëndojë peshorja (e veprave), do të jenë të suksesshëm.

فَمَنْ تَقَلَّتْ مَوَازِينُهُ فَأُولَئِكَ هُمُ  
الْمُفْلِحُونَ ﴿١٣﴾

104. Dhe ata të cilëve do t'u mbetet e lehtë peshorja, do t'i kenë shkaktuar humbje vetvetes. Do të mbesin gjatë në xhehenem.

وَمَنْ خَفَّتْ مَوَازِينُهُ فَأُولَئِكَ الَّذِينَ  
خَسِرُوا أَنفُسَهُمْ فِي جَهَنَّمَ خَالِدُونَ ﴿١٤﴾

105. Zjarri do t'ua djegë fytyrat dhe ata do të përçudnohen.

تَلْفَحُ وُجُوهَهُمُ النَّارُ وَهُمْ فِيهَا كَالِحُونَ ﴿١٥﴾

106. A nuk ju janë lexuar ajetet e Mia dhe ju i quanit gënjeshtre?!

أَلَمْ تَكُنْ أَلْتَمِ الْيَوْمِ الَّذِي تَكْتُمُ بِهَا  
تَكْذِبُونَ ﴿١٦﴾

107. Ata do të thonë: “O Zoti ynë! Na zuri fatkeqësia jonë dhe ne ishim popull i humbur.

قَالُوا رَبَّنَا غَلَبَتْ عَلَيْنَا شِقْوَتُنَا وَكُنَّا قَوْمًا  
ضَالِّينَ ﴿١٧﴾

108. O Zoti ynë! Na nxirr nga këtu, dhe nëse e përsërisim sërish, vërtet do të jemi keqbërës!”

رَبَّنَا أَخْرِجْنَا مِنْهَا فَإِن عُدْنَا فَإِنَّا  
ظَالِمُونَ ﴿١٨﴾

109. Ai do t'u thotë: “Zhdukuni aty dhe mos Më flisni!”

قَالَ اخْسَوْا فِيهَا وَلَا تَكَلَّمُونَ ﴿١٩﴾

110. Kishte një grup nga robërit e Mi që thoshin: “O Zoti ynë! Ne besuam. Andaj, na fal dhe na mëshiro! Ti je Mëshiruesi më i mirë!”

إِنَّهُ كَانَ فَرِيقٌ مِّنْ عِبَادِي يَقُولُونَ رَبَّنَا  
أَمَّا فَاغْفِرْنَا وَارْحَمْنَا وَأَنْتَ خَيْرُ  
الرَّحِيمِينَ ﴿٢٠﴾

111. Dhe ju i morët për tallje, derisa ata ju bënë të harronit kujtimin Tim dhe vijonit duke u përqeshur me ta.

فَاتَّخَذْتُمُوهُمْ سَخِرِيًّا حَتَّىٰ أَنسَوَكُم ذِكْرِي  
وَكُنْتُمْ مِنْهُمْ تَضْحَكُونَ ﴿٢١﴾

112. Pa dyshim, për atë që ata duruan, Unë sot i kam shpërblyer që të jenë të suksesshëm.

إِنِّي جَزَيْتُهُمُ الْيَوْمَ بِمَا صَبَرُوا إِنَّهُمْ هُمُ  
الْفَائِزُونَ ﴿٢٢﴾

113. Ai do t'i pyesë: “Sa vite qëndruat në tokë?”

قُلْ كَمْ لَبِئْتُمْ فِي الْأَرْضِ عَدَدَ سِنِينَ ﴿١١٣﴾

114. Ata do të thonë: “Qëndruam një ditë ose një pjesë të ditës, por pyeti llogaritësit.”

قَالُوا لَبِئْنَا يَوْمًا أَوْ بَعْضَ يَوْمٍ فَسَلِّ الْعَادِينَ ﴿١١٤﴾

115. Ai do t'u thotë: Vetëm pak keni qëndruar ju. Sikur ta kishit ditur!

قُلْ إِنْ لَبِئْتُمْ إِلَّا قَلِيلًا لَوْ أَنْتُمْ كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ ﴿١١٥﴾

116. A menduat se Ne ju krijuam pa qëllim dhe ju nuk do të ktheheshit te Ne?!

أَفَحَسِبْتُمْ أَنَّمَا خَلَقْنَاكُمْ عَبَثًا وَأَنَّكُمْ إِلَيْنَا لَا تُرْجَعُونَ ﴿١١٦﴾

117. Shumë i Lartë është Allahu, Sunduesi i Vërtetë. Nuk ka të adhurueshëm tjetër përveç Atij; Zoti i Fronit të Nderuar.

فَتَعَلَى اللَّهِ الْمَلِكُ الْحَقُّ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ رَبُّ الْعَرْشِ الْكَرِيمِ ﴿١١٧﴾

118. Dhe ai që u lutet të adhureshmëve të tjerë bashkë me Allahun, për të cilin nuk ka asnjë argument, llogaria e tij është te Zoti i tij. Njëmend, mohuesit nuk gëzojnë sukses.

وَمَنْ يَدْعُ مَعَ اللَّهِ إِلَهًا آخَرَ لَا بُرْهَانَ لَهُ بِهِ فَإِنَّمَا حِسَابُهُ عِنْدَ رَبِّهِ إِنَّهُ لَا يُفْلِحُ الْكٰفِرُونَ ﴿١١٨﴾

119. Thuaj: “O Zoti im! Fal dhe mëshiro! Ti je Mëshiruesi më i mirë!”

وَقُلْ رَبِّ اغْفِرْ وَارْحَمْ وَأَنْتَ خَيْرُ الرَّحِيمِينَ ﴿١١٩﴾

## Surja 24 – En-Nur

Surja En-Nur është medinase dhe zbriti në vitin e pestë pas hixhretit. Bashkë me *bismil-lahin* ajo ka gjashtëdhjetë e pesë ajete.

Në fillim të sures paraardhëse, El-Mu'minun, janë paraqitur shenjat e besimtarëve dhe në mënyrë të theksuar është thënë se besimtarët ruajnë organet e tyre intime (*furuxh*). Në thelb, edhe surja En-Nur lidhet me këtë temë. Që në fillim flet për ndëshkimin që u jepet mashkullit dhe femrës që bëjnë kurvëri. Gjithashtu thuhet se njerëzit e papastër mbajnë lidhje të papastra, kurse besimtarët e vërtetë interesohen fort të rrinë larg papastërtisë e të gjejnë lidhje të pastra. Duke e vijuar të njëjtën temë, Zoti tha se ata fatligë që akuzojnë gratë e ndershme për pandershmëri, do të ndëshkohen rëndë. Po në këtë sure flitet për ngjarjen sesi disa fatligë akuzuan për një gjë të tillë edhe *Hazret Aishen*<sup>ra</sup>, që ishte një grua jashtëzakonisht e ndershme. Po ashtu, flitet edhe për ndëshkimin e tyre.

Më pas, ata që praktikojnë jetë të pastër, Zoti i Madhërishëm u jep porosi, të cilat nëse i zbatojnë, Zoti ua shton pastërtinë edhe më shumë. Për shembull, t'u japin selam para se të hyjnë në ndonjë shtëpi, në mënyrë që të mos i gjejnë banorët e shtëpisë në gjendje të shkujdesur, sepse edhe kjo mund të bëhet shkak i devijimit të mendimeve. Një porosi tjetër e rëndësishme në këtë vazhdë është që edhe burrat besimtarë, edhe gratë besimtare të mbajnë të ulur shikimin dhe të frenojnë veten nga kundrimi i lirshëm ndaj gjinisë së kundërt.

Pas gjithë kësaj teme, *Hazret Profeti Muhammed*<sup>savs</sup> është paraqitur si një shëmbëlltyrë e fuqishme e dritës së Allahut të Madhërishëm, duke thënë se ajo nuk është as lindore, as perëndimore dhe që do të ndriçonte njësoj edhe Lindjen, edhe Perëndimin. Kjo dritë është si një llambë, e cila do të ndizte shumë llamba të tjera. Më pas, jepet një skicë e shtëpive të sahabëve<sup>ra</sup> sesi Profeti Muhammed<sup>savs</sup> ndezi të njëjtën dritë edhe në to.

Më pas jepen dy shembuj për mohuesit. Në shembullin e parë thuhet se përpjekjet që ata bëjnë vazhdimisht, për ta shuar etjen e dëshirave dhe të kënaqësive të kësaj bote, më në fund u kthehen në dëshpërime, sikur ai që vrapon në shkretëtirë duke pandehur mirazhin për ujë, por kur mbërrin atje, përballet vetëm me ndëshkimin si pasojë se e gënjeu veten kaq gjatë.

Në shembullin e dytë për mohuesit thuhet se kur i shmangen dritës së Zotit, i mbulojnë errësitat duke iu shtresuar njëra mbi tjetrën, me fjalë të tjera, është sikur të përfundojnë në thellësi të detit, dhe sipër, t'u mbulohet qielli me re të dendura, duke u shkaktuar një mbivendosje errësirash, aq saqë ata nuk arrijnë ta shohin as dorën e vet.

Në ajetin 52, Zoti i Madhërishëm thotë se besimtarët e vërtetë janë ata, të cilët kur thirren drejt Allahut dhe të Dërguarit të Tij, menjëherë i përgjigjen. Duke përmendur fitoren (*felah*), Zoti na rikujtoi fjalët që tha në fillim të sures paraardhëse "Sigurisht,

fituan besimtarët” dhe e ritheksoi se pikërisht besimtarët e tillë do të fitojnë.

Po në këtë sure vjen ajeti *istikhlaf*, që thotë se Allahu i Madhërishëm u ka premtuar besimtarëve Kalifatin dhe, ashtu siç pas Profetëve të mëparshëm Ai caktoi kalifë të tyre, në të njëjtën mënyrë, edhe pas Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, kalifët e tij do të caktohen me urdhrin e Zotit. Pavarësisht se do të zgjidhen nga një grup besimtarësh, një shenjë që kalifët janë caktuar prej Zotit është që në situata kur armiqtë do të ndihen të fuqishëm për t’i mposhtur besimtarët, përmes kalifëve Zoti i Madhërishëm do t’ua shndërrojë frikën në siguri.

Kjo sure flet vijueshmërisht për bindjen e përsosur që duhet të tregojnë besimtarët. Një shenjë e kësaj bindjeje është që ata jo vetëm që i binden të Dërguarit të Allahut<sup>savs</sup>, por e respektojnë jashtëzakonisht shumë, aq sa që kur mblidhen diku për të diskutuar rreth besimit, kurrsesi nuk largohen nga takimi pa i marrë leje të Dërguarit të Allahut<sup>savs</sup>. Gjithashtu, Zoti i Madhërishëm u jep mësimin edhe të paedukuarve të mos e thërrasin të Dërguarin e Allahut<sup>savs</sup> duke bërë titur, siç thërrasin njëri-tjetrin.

Në ajetin e fundit të kësaj sureje thuhet se çdo pretendim që bëni mund të jetë edhe i sinqertë, por edhe hipokrit, dhe se vetëm Allahu i Madhërishëm e di më së miri se në çfarë gjendje jeni.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithë-mëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ۝

2. Një sure që zbritëm dhe e bëmë të obliguar, dhe në të zbritëm ajete të qarta, që ju të mendoheni.

سُورَةٌ أَنْزَلْنَاهَا وَفَرَضْنَاهَا وَأَنْزَلْنَا فِيهَا آيَاتٍ بَيِّنَاتٍ لَّعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ ۝

3. Lavirja dhe laviri. Secilin prej tyre kamxhikoni me nga njëqind kamxhikë. Le të mos ju kaplojë ndonjë (ndjenjë) butësie për ta në lidhje me fenë e Allahut, nëse besoni Allahun dhe Ditën e *Ahiretit*. Dhe ndëshkimin e tyre le ta dëshmojë një grup besimtarësh.

الزَّانِيَةُ وَالزَّانِي فَاجْلِدُوا كُلَّ وَاحِدٍ مِّنْهُمَا مِائَةَ جَلْدَةٍ ۚ وَلَا تَأْخُذْكُمْ بِهِمَا رَأْفَةٌ فِي دِينِ اللَّهِ إِنْ كُنْتُمْ تُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ ۚ وَلَيْشَهِدَ عَذَابُهُمَا طَآئِفَةٌ مِّنَ الْمُؤْمِنِينَ ۝

4. Laviri (natyrisht) nuk martohet përveçse me një lavire a idhujtare. Edhe me laviren (natyrisht) nuk martohet ndokush përveçse një lavir a idhujtar. Kjo (ligësi) është bërë e ndaluar për besimtarët.<sup>1</sup>

الزَّانِي لَا يَنْكِحُ إِلَّا زَانِيَةً أَوْ مُشْرِكَةً ۚ وَالزَّانِيَةُ لَا يَنْكِحُهَا إِلَّا زَانٍ أَوْ مُشْرِكٌ ۚ وَحَرَّمَ ذَٰلِكَ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ ۝

5. Ata që akuzojnë të dëlirat (për pandershmëri), më pas nuk sjellin

وَالَّذِينَ يَرْمُونَ الْمُحْصَنَاتِ ثُمَّ لَمْ يَأْتُوا بِآرْبَعَةِ شُهَدَاءَ فَاجْلِدُوهُمْ ثَمَانِينَ جَلْدَةً

1. Fjala arabe *nikah* në shqip zakonisht përkthehet si *martesë*, *kurorëzim*, pra, si marrëveshje fetare e ligjore për një çift, dhe kjo është bërë si term i përgjithshëm, të cilin e ka përdorur edhe Kurani i Shenjtë vazhdimisht (33:50; 4:23; 2:231). Megjithatë, fjalorët tregojnë se fjala *nikah* ka edhe kuptimin e marrëdhënieve seksuale. Duke mos e pasur parasysh këtë kuptim të dytë, disa njerëz nxjerrin kuptime qesharake të këtij ajeti. Kuptimi i thjeshtë i këtij ajeti është që kur një njeri shkon me një prostitutë, edhe ai kurvar do të quhet dhe jo bashkëshort i saj, dhe po kështu është edhe anasjelltas. Gjithashtu, kur një burrë dhe një grua bëjnë marrëdhënie të jashtëligjshme, asnjë prej të dyve nuk quhet bashkëshort/e i tjetrit, por që të dy kanë bërë imoralitet. Ky mesazh i ajetit nuk u kuptua nga disa njerëz, të cilët e kanë kuptuar se kurvari mund të martohet vetëm me një prostitutë dhe anasjelltas. Bota mund të ketë shumë shembuj kur një burrë i pamoralshëm të jetë i martuar me një grua të moralshme dhe nga ndikimi i mirë i kësaj të fundit, ai të jetë bërë i moralshëm, po kështu mund të ketë ndodhur edhe anasjelltas.

katër dëshmitarë, kamxhikoni me nga tetëdhjetë kamxhikë dhe kurrë mos u pranoni më dëshmi. Pikërisht këta janë të ligjtë.<sup>2</sup>

6. Përveç atyre që u penduan pas kësaj dhe u përmirësuan, atëherë Allahu përnjëmend është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

7. Dhe ata që akuzojnë bashkëshortet e veta (për tradhti), ndërkohë që nuk kanë ndonjë dëshmitar përveç vetvetes, atëherë çdo i tillë le të dëshmojë katër herë duke u betuar në Allah se ai është i vërtetë (dhe thotë të vërtetën),

8. dhe në herën e pestë (të shprehet) se mallkimi i Allahut qoftë mbi të nëse është gënjeshtar.

9. Ajo që do t'ia largojë ndëshkimin asaj (gruaje) është që edhe ajo të dëshmojë katër herë duke u betuar në Allah se ai (burrë) është gënjeshtar,

10. dhe në herën e pestë (të shprehet) se ndëshkimi i Allahut do ta zërë atë (grua), nëse ai është i vërtetë (dhe thotë të vërtetën).

وَلَا تَقْبَلُوا لَهُمْ شَهَادَةً أَبَدًا ۗ وَأُولَٰئِكَ هُمُ  
الْفٰسِقُونَ ۝

إِلَّا الَّذِينَ تَابُوا مِنْ بَعْدِ ذٰلِكَ وَأَصْلَحُوا ۗ  
فَإِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَّحِيمٌ ۝

وَالَّذِينَ يَرْمُونَ أَزْوَاجَهُمْ وَلَمْ يَكُنْ لَهُمْ  
شَهَادَةٌ إِلَّا أَنفُسُهُمْ فَشَهَادَةُ أَحَدِهِمْ  
أَرْبَعٌ شَهَدَاتٍ بِاللَّهِ ۗ إِنَّهُ لَمِنَ الصّٰدِقِينَ ۝

وَالْحَامِسَةُ أَنَّ لَعْنَتَ اللَّهِ عَلَيْهِ إِنْ كَانَ  
مِنَ الْكٰذِبِينَ ۝

وَيَدْرَأُ عَنْهَا الْعَذَابَ إِنْ تَشْهَدَ أَرْبَعٌ  
شَهَدَاتٍ بِاللَّهِ ۗ إِنَّهُ لَمِنَ الْكٰذِبِينَ ۝

وَالْحَامِسَةُ أَنَّ غَضَبَ اللَّهِ عَلَيْهَا إِنْ كَانَ  
مِنَ الصّٰدِقِينَ ۝

2. Ky ajet parandalon shpifjet për imoralitet ndaj grave të ndershme, sepse për një akuzë të tillë janë kërkuar katër dëshmitarë okularë, në të kundërt, akuzuesit dënohen me ndëshkim të rëndë. Kjo natyrisht nuk u jep aspak inkurajim atyre që akuzojnë duke u nisur nga paragjykimet.

Një gjë tjetër që tregon ky ajet lidhet me faktin që një gjë të tillë ia kishin bërë vetë Hazret Aishes<sup>ra</sup>, bashkëshortes së Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, ata që u morën me thashetheme, kurse Profeti<sup>savs</sup> nuk mbajti asnjë qëndrim derisa Allahu i Madhërishtëm shpalli pafajësinë e saj, ngjarje e cila përmendet hollësisht në hadithe.

11. Vallë, (çfarë do të ndodhte me ju) sikur të mos e kishit bekimin e Allahut dhe mëshirën e Tij?! Sigurisht, Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

12. Ata që sajuan shpifjen janë një grup prej jush. Mos e mendoni këtë (çështje) si të keqe për ju, përkundrazi, ajo është mirë për ju. Secili njeri prej tyre do ta ketë atë që ka konsumuar nga mëkati. Dhe prej tyre ai që pati përgjegjësinë më të madhe të kësaj (shpifjeje), do të ketë ndëshkim të madh.

13. Vallë, pse nuk ndodhi që kur e dëgjuat këtë, besimtarët dhe besimtare të mendonin diçka të mirë për njerëzit e vet dhe të thoshin: “Kjo është shpifje e hapur”?!

14. Pse ata nuk sollën katër dëshmitarë për këtë (çështje)?! Dhe derisa nuk i sollën dëshmitarët, atëherë tek Allahu pikërisht ata janë gënjeshtarë.

15. Nëse nuk do të kishit mbi vete bekimin e Allahut dhe mëshirën e Tij në këtë botë dhe në *ahiret*, si pasojë e kësaj (ngatërrese) ku keni rënë, do t’ju prekte pashmangshmërisht një ndëshkim i madh.

16. Kur e pranoni atë (gënjeshtër) në gjuhët tuaja dhe me gojët tuaja e thoshit atë për të cilën nuk kishit dije dhe e mendoni të lehtë, kurse tek Allahu ajo ishte shumë e rëndë.

وَلَوْ لَا فَضْلُ اللَّهِ عَلَيْكُمْ وَرَحْمَتُهُ وَأَنَّ  
اللَّهِ تَوَّابٌ حَكِيمٌ ﴿١١﴾

إِنَّ الَّذِينَ جَاءُوا بِالْإِفْكِ عُصْبَةٌ مِّنْكُمْ  
لَا تحْسَبُوهُ شَرًّا لَّكُمْ بَلْ هُوَ خَيْرٌ لَّكُمْ لِكُلِّ  
أَمْرٍ مِّنْهُمْ مَا اكْتَسَبَ مِنَ الْإِثْمِ  
وَالَّذِي تَوَلَّى كِبْرَهُ مِنْهُمْ لَهُ عَذَابٌ  
عَظِيمٌ ﴿١٢﴾

لَوْ لَا إِذْ سَمِعْتُمُوهُ ظَنَّ الْمُؤْمِنُونَ  
وَالْمُؤْمِنَاتُ بَأَنفُسِهِمْ خَيْرًا وَّ قَالُوا هَذَا  
إِفْكٌ مُّبِينٌ ﴿١٣﴾

لَوْ لَا جَاءَ وَعَلَيْهِ بِأَرْبَعَةِ شُهَدَاءَ فَإِذْ لَمْ  
يَأْتُوا بِالشُّهَدَاءِ فَأُولَئِكَ عِنْدَ اللَّهِ هُمُ  
الْكَاذِبُونَ ﴿١٤﴾

وَلَوْ لَا فَضْلُ اللَّهِ عَلَيْكُمْ وَرَحْمَتُهُ فِي الدُّنْيَا  
وَالْآخِرَةِ لَمَسَّكُمْ فِي مَا أَفَضْتُمْ فِيهِ عَذَابٌ  
عَظِيمٌ ﴿١٥﴾

إِذْ تَلَقَّوْنَهُ بِاللِّسَانِ كَمَا وَتَقُولُونَ بِأَفْوَاهِكُمْ  
مَا لَيْسَ لَكُمْ بِهِ عِلْمٌ وَّ تحْسَبُونَهُ هَيِّئًا  
وَهُوَ عِنْدَ اللَّهِ عَظِيمٌ ﴿١٦﴾

17. Pse nuk ndodhi që kur e dëgjuat, të thoshit: “Nuk kemi të drejtë të flasim për këtë (çështje); i Shenjtë je Ti (o Allah)! Kjo është shpifje e madhe!”

وَلَوْلَا إِذْ سَمِعْتُمُوهُ قُلْتُمْ مَا يَكُونُ لَنَا  
أَنْ نَتَكَلَّمَ بِهَذَا سُبْحَانَكَ هَذَا بُهْتَانٌ  
عَظِيمٌ ﴿١٧﴾

18. Allahu ju këshillon që kurrë të mos përsërisni diçka të tillë, nëse jeni besimtarë.

يَعْظُمُ اللَّهُ أَنْ تَعُودُوا لِمِثْلِهِ أَبَدًا إِنْ  
كُنْتُمْ مُؤْمِنِينَ ﴿١٨﴾

19. Allahu ju shpjegon qartë ajetet dhe Allahu është i Gjithëdijshëm, i Urtë.

وَيَبِّينُ اللَّهُ لَكُمْ الْآيَاتِ وَاللَّهُ عَلِيمٌ  
حَكِيمٌ ﴿١٩﴾

20. Njëmend, ata të cilët duan që imoraliteti të përhapet mes njerëzve që besuan, do të kenë ndëshkim të dhimbshëm në këtë botë dhe në *ahiret*. Allahu di dhe ju nuk dini.<sup>3</sup>

إِنَّ الَّذِينَ يُجِبُونَ أَنْ تَشِيَعَ الْفَاحِشَةُ فِي  
الدُّنْيَا أَمْوَا لَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ فِي الدُّنْيَا  
وَالْآخِرَةِ وَاللَّهُ يَعْلَمُ وَأَنْتُمْ لَا تَعْلَمُونَ ﴿٢٠﴾

21. Sikur të mos ishte bekimi i Allahut dhe mëshira e Tij mbi ju, (do të ishte përhapur imoraliteti mes jush) dhe sigurisht, Allahu është shumë i Dhembshur, shumë Mëshirëbërës.

وَلَوْلَا فَضْلُ اللَّهِ عَلَيْكُمْ وَرَحْمَتُهُ وَأَنَّ  
لِلَّهِ عِندَ اللَّهِ رِءُوفٌ رَحِيمٌ ﴿٢١﴾

22. O ju që besuat! Mos ndiqni hapat e djallit! Ai që i ndjek hapat e djallit, (le ta dijë) se ai përnjëmend urdhëron imoralitetin dhe veprën e shëmtuar. Dhe sikur të mos ishte bekimi i Allahut dhe mëshira e Tij mbi ju, askush prej jush asnjëherë nuk do të pastrohej. Por Allahu pastron kë të dojë. Allahu është Gjithëdëgjues, i Gjithëdijshëm.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَتَّبِعُوا خُطُوَاتِ  
الشَّيْطَانِ وَمَنْ يَتَّبِعْ خُطُوَاتِ الشَّيْطَانِ فَإِنَّهُ  
يَأْمُرُ بِالْفَحْشَاءِ وَالْمُنْكَرِ وَلَوْ لَا فَضْلُ  
اللَّهِ عَلَيْكُمْ وَرَحْمَتُهُ مَا زَكَا مِنْكُمْ مِنْ  
أَحَدٍ أَبَدًا وَلَكِنَّ اللَّهَ يُزَكِّي مَنْ يَشَاءُ  
وَاللَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ ﴿٢٢﴾

3. Pra, ata që akuzojnë të tjerët për imoralitet pa pasur prova të mjaftueshme, e popullarizojnë imoralitetin, saqë për shkak të tyre, shumë njerëz guxojnë të bëjnë imoralitet, duke e parë atë si një veprim të lehtë.



23. Nuk duhet të zotohen të begatët dhe të pasurit prej jush për të mos u dhënë diçka të afërmve, nevojtarëve dhe muhaxhirëve në rrugën e Allahut. Duhet që ata të falin dhe të tolerojnë. A nuk doni që Allahu t'ju falë ju?! Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

24. Ata që akuzojnë (gratë) e dëlira, të pafajshme besimtare, janë të mallkuar në këtë botë dhe në *ahiret*; dhe ata do të kenë ndëshkim të rëndë.

25. (Mos harroni) ditën kur gojët, duart dhe këmbët e tyre do të dëshmojnë vetë kundër tyre për atë që ata bënin.

26. Ditën kur Allahu do t'ua japë plotësisht dënimin e tyre të vërtetë dhe ata do të mësojnë se pikërisht Allahu është e Vërteta e qartë.

27. Gratë e këqija janë për burra të këqij dhe burrat e këqij janë për gratë e këqija. Po ashtu, gratë e pastra janë për burrat e pastër dhe burrat e pastër janë për gratë e pastra. Këta janë të pafajshëm nga ato që ata thonë dhe pikërisht këta do të kenë falje dhe dhurëti të nderuar.<sup>4</sup>

28. O ju që besuat! Mos hyni në shtëpitë e të tjerëve, derisa t'u merrni leje e t'u thoni *selam* të zotëve të tyre. Kjo është mirë për ju, që ju të reflektoni.

وَلَا يَأْتَلِ أُولُو الْفَضْلِ مِنْكُمْ وَالسَّعَةِ  
 أَنْ يُؤْتُوا أُولِي الْقُرْبَىٰ وَالْمَسْكِينِ  
 وَالْمُهَاجِرِينَ فِي سَبِيلِ اللَّهِ ۗ وَيَحْفُوا  
 وَيَصْفَحُوا ۗ أَلَا نُحِبُّونَ أَنْ يَغْفِرَ اللَّهُ  
 لَكُمْ ۗ وَاللَّهُ غَفُورٌ رَحِيمٌ ﴿١٧﴾

إِنَّ الَّذِينَ يَرْمُونَ الْمُحْصَنَاتِ الْغَافِلَاتِ  
 الْمُؤْمِنَاتِ لُعُنُوا فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ ۗ وَلَهُمْ  
 عَذَابٌ عَظِيمٌ ﴿١٨﴾

يَوْمَ تَشْهَدُ عَلَيْهِمْ أَلْسِنُهُمْ وَأَيْدِيهِمْ  
 وَأَرْجُلُهُمْ بِمَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿١٩﴾

يَوْمَذِ يُنْفِقُ اللَّهُ دِيْنَهُمُ الْحَقَّ  
 وَيَعْلَمُونَ أَنَّ اللَّهَ هُوَ الْحَقُّ الْمُبِينُ ﴿٢٠﴾

الْحَيْثُ لِلْحَيْثِينَ وَالْحَيْثُونَ لِلْحَيْثَاتِ  
 وَالطَّيِّبَاتُ لِلطَّيِّبِينَ وَالطَّيِّبُونَ لِلطَّيِّبَاتِ  
 أُولَٰئِكَ مُبَرَّءُونَ مِمَّا يَقُولُونَ ۗ لَهُمْ مَغْفِرَةٌ  
 ۖ وَرِزْقٌ كَرِيمٌ ﴿٢١﴾

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَدْخُلُوا بُيُوتًا  
 غَيْرَ بُيُوتِكُمْ حَتَّىٰ تَسْأَلُوا وَتُسَلِّمُوا  
 عَلَىٰ أَهْلِهَا ۗ ذَٰلِكُمْ خَيْرٌ لَّكُمْ لَعَلَّكُمْ  
 تَذَكَّرُونَ ﴿٢٢﴾

4. Ky ajet tregon një parim që burrat e papastër në përgjithësi zgjedhin gra të papastra, megjithatë, mund të ketë edhe përjashtime. Gjithashtu, burrat e pastër martohen me gratë e pastra dhe edhe këtu mund ketë përjashtime.

29. Nëse nuk gjeni dikë në ato (shtëpi), mos hyni në to, derisa t'ju jepet leje. Dhe nëse ju thuhet: "Kthehuni!", atëherë kthehuni! Kjo është më e pastër për ju. Allahu është i Gjithëdijshëm për atë që bëni.

30. Nuk është gjynah për ju nëse hyni në shtëpi që nuk janë të banuara e që ka ndonjë gjë tuajën. Allahu e di atë që shfaqni, si dhe atë që fshihni.

31. Thuaju besimtarëve të ulin shikimet e tyre dhe të ruajnë organet e tyre intime. Kjo mënyrë është më e pastër për ta. Sigurisht, Allahu është i Gjithinformuar për atë që ata bëjnë.<sup>5</sup>

32. Thuaju edhe besimtareve të ulin shikimet e tyre, të ruajnë organet e tyre intime dhe të mos e shfaqin bukurinë e tyre, përveç asaj pjese që shfaqet vetvetiu; të mbajnë shaminë e tyre të kokës sipër kraharorëve;<sup>6</sup>

فَإِنْ لَّمْ تَجِدُوا فِيهَا أَحَدًا فَلَا تَدْخُلُوهَا  
حَتَّىٰ يُؤْذَنَ لَكُمْ ۗ وَإِنْ قِيلَ لَكُمْ ارْجِعُوا  
فَارْجِعُوا هُوَ أَزْكَىٰ لَكُمْ ۗ وَاللَّهُ بِمَا  
تَعْمَلُونَ عَلِيمٌ ﴿٢٩﴾

لَيْسَ عَلَيْكُمْ جُنَاحٌ أَنْ تَدْخُلُوا بُيُوتًا غَيْرَ  
مَسْكُونَةٍ فِيهَا مَتَاعٌ لَّكُمْ ۗ وَاللَّهُ يَعْلَمُ مَا  
تُبْدُونَ وَمَا كُنْتُمْ مَوَٰجِدِينَ ﴿٣٠﴾

قُلْ لِلْمُؤْمِنِينَ يَعْضُوا مِنْ أَبْصَارِهِمْ  
وَ يَحْفَظُوا فُرُوجَهُمْ ۗ ذَلِكَ أَزْكَىٰ لَهُمْ  
إِنَّ اللَّهَ خَبِيرٌ بِمَا يَصْعَوْنَ ﴿٣١﴾

وَقُلْ لِلْمُؤْمِنَاتِ يَحْضُنْنَ مِنْ أَبْصَارِهِنَّ  
وَيَحْفَظْنَ فُرُوجَهُنَّ وَلَا يُبْدِينَ زِينَتَهُنَّ  
إِلَّا مَا ظَهَرَ مِنْهَا وَلْيَضْرِبْنَ بِخُمُرِهِنَّ  
عَلَىٰ جُيُوبِهِنَّ ۗ وَلَا يُبْدِينَ زِينَتَهُنَّ إِلَّا

5. Frenimi i shikimit nga gjërat e huaja dhe vetëm shikimi i gjërave të lejuara, në arabisht quhet *gad-de basar*. Çdo besimtar që dëshiron të mbajë pastër zemrën e tij, nuk duhet të vështrojë ku të dojë në mënyrë të pafre si kafshët, por në këtë jetë shoqërore, i duhet të mësohet me metodën e *uljes së shikimit*, sepse kjo shprehi e bekuar do t'ia shndërron gjendjen e tij instinktive në një moral të lartë, njëherësh ai nuk do të humbë asgjë nga nevojat shoqërore. Pikërisht ky është ai moral, që quhet *ihsan* dhe *dëllirësi*. Pra, Zoti u thotë besimtarëve që ata duhet t'i ruajnë sytë, veshët dhe organet e tyre intime nga gjinia tjetër, sepse kjo është metoda që u mundëson pastrimin shpirtëror, pasi shpirti i tyre do të jetë i mbrojtur nga tundimet. Mosedukimi i këtyre organeve i shkakton njeriut tundime të pamposhtshme. Nëse syri nuk është i pastër, as zemra nuk mund të jetë e pastër.

6. Mbulesa islame nuk është si burg, por si një barrierë që një grua dhe një burrë i huaj të mos e shohin njëri-tjetrin. Pra, mbulesa islame të ruan nga rrëshqitjet. Nëse dëshirojmë të shpëtojmë nga pandershmeria, duhet ta ruajmë veten. Por nëse nuk e ruajmë veten dhe kujtojmë se jemi njerëz të mirë, patjetër që do të rrëshqasim. Mësimi i Islamit për mbulesë vjen pasi i porosit burrat për *uljen e shikimit* në ajetin paraardhës, dhe vjen që të ruhet pastërtia shpirtërore mes burrave dhe grave në shoqëri. Lexoni edhe 33:60.

gjithashtu të mos e shfaqin bukurinë e tyre përveçse për burrat e tyre, baballarët e tyre, baballarët e burrave të tyre, djemtë e tyre, djemtë e burrave të tyre, vëllezërit e tyre, djemtë e vëllezërve të tyre, djemtë e motrave të tyre, gratë (a shoqet) e tyre, burrat që janë në zotërimin e tyre, shërbëtorët meshkuj që nuk kanë nevoja (trupore) dhe fëmijët të cilët nuk kanë akoma dijeni për intimitetet e grave; dhe (thuaju) të mos përplasni këmbët e tyre për të treguar pjesë nga bukuria e tyre që (zakonisht gratë) e fshehin. Dhe, o besimtarë! Ju të gjithë përuluni duke u penduar tek Allahu, që të keni sukses.

33. Martoni edhe të vejat që janë mes jush, si dhe të dëlirët prej skllëvërve dhe skllaveve tuaja. Nëse ata janë të varfër, Allahu do t'i pasurojë me bekimin e Tij. Allahu është Zgjerues, i Gjithëdijshëm.

34. Kurse ata që nuk gjejnë mundësi të martohen, duhet ta ruajnë veten, derisa Allahu t'i pasurojë me bekimin e Tij. Dhe prej atyre që janë në zotërimin tuaj, ata që dëshirojnë të bëjnë marrëveshje me shkrim për lirimin e tyre, nënshkruajuni nëse vëreni mirësinë te ta. Jepuni edhe atyre diçka nga pasuria që Allahu ju ka dhënë juve. Skllavet tuaja nëse dëshirojnë të martohen, mos i detyroni për imoralitet (duke i mbajtur të pamartuara), se kështu do të kërkonin përfitimin e kësaj bote.

لِيُحَوِّلَهُنَّ أَوْ آبَائَهُنَّ أَوْ أَبَائَهُنَّ أَوْ أَبَائَهُنَّ أَوْ أَبَائَهُنَّ أَوْ أَبَائَهُنَّ  
 أَوْ أَبَائَهُنَّ أَوْ أَبَائَهُنَّ أَوْ أَبَائَهُنَّ أَوْ أَبَائَهُنَّ أَوْ أَبَائَهُنَّ  
 أَوْ بَنِي إِخْوَانِهِنَّ أَوْ بَنِي إِخْوَانِهِنَّ أَوْ بَنِي إِخْوَانِهِنَّ أَوْ بَنِي إِخْوَانِهِنَّ  
 نِسَابَهُنَّ أَوْ مَا مَلَكَتْ أَيْمَانُهُنَّ أَوْ الشُّعْبَيْنِ  
 غَيْرِ أُولِي الْأَرْبَابَةِ مِنَ الرِّجَالِ أَوْ الطِّفْلِ  
 الَّذِينَ لَمْ يَطْهَرُوا عَلَى عَوْرَتِ النِّسَاءِ  
 وَلَا يَضْرِبْنَ بِأَرْجُلِهِنَّ لِيُعْلَمَ مَا يُخْفَيْنَ  
 مِنْ زِينَتِهِنَّ ۗ وَتُؤْتَوْنَ إِلَى اللَّهِ جَمِيعًا أَيُّهُ  
 الْمُؤْمِنُونَ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ ﴿٣٣﴾

وَأَنْكِحُوا الْأَيَامَىٰ مِنْكُمْ وَالصَّالِحِينَ مِنْ  
 عِبَادِكُمْ وَإِمَائِكُمْ ۗ إِنْ يَكُونُوا فُقَرَاءَ  
 يُعْنِهِمُ اللَّهُ مِنْ فَضْلِهِ ۗ وَاللَّهُ وَاسِعٌ  
 عَلِيمٌ ﴿٣٣﴾

وَلَيْسَتَعْفَى الَّذِينَ لَا يَحْدُونَ نِكَاحًا  
 حَتَّىٰ يُعْنِيَهُمُ اللَّهُ مِنْ فَضْلِهِ ۗ وَالَّذِينَ  
 يَبْتَغُونَ الْكِتَابَ مِمَّا مَلَكَتْ أَيْمَانُكُمْ  
 فَكَاتِبُوهُمْ إِنْ عَلِمْتُمْ فِيهِمْ خَيْرًا ۗ وَ  
 أَوْلَاهُمْ مِنْ مَالِ اللَّهِ الَّذِي آتَاكُمْ ۗ وَلَا  
 تُكْرِهُوا فَتِيانِكُمْ عَلَى الْبِغَاءِ إِنْ أَرَدْنَ  
 تَحْصُنَا لِنَبْتَغُوا عَرَضَ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا  
 وَمَنْ يُكْرِهِنَّ فَإِنَّ اللَّهَ مِنْ بَعْدِ

Nëse dikush i detyron ato, atëherë pas detyrimit të tyre Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës (për to).

إِكْرَاهِيْنَ غَفُوْرٌ رَّحِيْمٌ ﴿١٦﴾

35. Pa dyshim, Ne zbritëm tek ju ajete ndriçuese, një shembull të atyre që kaluan para jush dhe këshillë për të druajturit (ndaj Zotit).

وَلَقَدْ أَنْزَلْنَا إِلَيْكُمْ آيَاتٍ مُّبَيِّنَاتٍ وَمَثَلًا مِّنَ الَّذِينَ خَلَوْا مِن قَبْلِكُمْ وَمَوْعِظَةً لِّلْمُتَّقِينَ ﴿١٧﴾

36. Allahu është drita e qiejve dhe e tokës. Shembulli i dritës së Tij është si një kamare, në të cilën ka një llambë. Llamba është në qelq. Qelqi është si një yll i shndritshëm; ajo (llambë) ndizet nga pema e bekuar e ullirit, as lindore e as perëndimore, vaji i saj ka mundësi të ndizet vetë, qoftë pa e prekur zjarri. Dritë mbi dritë. Allahu udhëzon drejt dritës së Tij kë të dojë. Allahu jep shembujt për njerëzit. Allahu është i Gjithëdijshëm për çdo gjë.<sup>7</sup>

اللَّهُ نُورُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ مِثْلُ نُورِهِ كَمِشْكُوتٍ فِيهَا مِصْبَاحٌ الْمِصْبَاحُ فِي رُجَاةٍ الرَّجَاةُ كَأَنَّهَا كَوْكَبٌ دُرِّيٌّ يُوقَدُ مِنْ شَجَرَةٍ مُّبْرَكَةٍ زَيْتُونَةٍ لَا شَرْقِيَّةٍ وَلَا غَرْبِيَّةٍ يَكَادُ زَيْتُهَا يُضِيءُ وَلَوْ لَمْ تَمْسَسْهُ نَارٌ نُورٌ عَلَى نُورٍ يَهْدِي اللَّهُ لِنُورِهِ مَن يَشَاءُ وَيَضْرِبُ اللَّهُ الْأَمْثَالَ لِلنَّاسِ وَاللَّهُ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ ﴿١٨﴾

7. Zoti është drita e qiejve dhe e tokës, domethënë çdo shkëlqim që shihet në lartësi e në ultësi, qoftë në shpirtat apo në trupat, qoftë e dhuruar apo e fituar, qoftë e hapur apo e fshehur, qoftë mendore apo fizike, është dhunti që buron prej bekimit të Tij. Kjo tregon se bekimi i përgjithshëm i Zotit të botëve përfshin çdo gjë dhe se asnjë gjë nuk është jashtë tij. Por, karshi kësaj drite është edhe një dritë e veçantë, e cila është e kushtëzuar nga shumë gjëra dhe që u jepet vetëm atyre, të cilët janë të aftë të përfitojnë nga ajo dhe ata janë profetët, më të përsosurit nga njerëzit. Kështu, shembulli i dritës është Profeti Muhammed<sup>savs</sup>. Kamarja është kraharori i tij i çiltër në të cilin ka një llambë, pra shpallja e Zotit. Llamba është ruajtur në një qelq që është shumë i pastër, d.m.th. në zemrën e Profetit<sup>savs</sup>, dhe ajo i përngjan një kristali të pastër, pasi gjendet larg çdo shtrembërie dhe papastërtie dhe që nuk mban asnjë lidhje tjetër përveç lidhjes së Zotit. Kristali është aq i pastër, sikur të jetë një yll i shndritshëm që shkëlqen madhërisht në horizontin e qiellit. Llamba është ndezur nga pema e bekuar e ullirit. Pema e bekuar e ullirit simbolizon qenien e bekuar të Muhammedit, sepse natyrshmeria e tij e ka arritur përsosurinë, është e baraspeshuar, përmbledhje e lloj-lloj bekimesh, nuk është e kufizuar me ndonjë vend, as lindore e as perëndimore, e as e kufizuar me ndonjë kohë, madje

37. Në shtëpi, për të cilat Allahu ka urdhëruar që ato të lartësohen dhe në to të përmendet emri i Tij, ata e lavdërojnë në to mëngjeseve e mbrëmjeve.

38. Janë burra që as tregtia e as shitblerja nuk ua largojnë vëmendjen nga përmendja e Allahut, nga kryerja e namazit dhe nga dhënia e zekatit. Ata frikësohen prej ditës kur do të dridhen zemrat dhe sytë.

39. Që Allahu t'i shpërblejë ata sipas veprave më të mira që kanë bërë dhe t'ua shtojë edhe më shumë me bekimin e Tij. Allahu kë të dojë dhuron pa masë.

40. Dhe ata që mohuan, veprat e tyre janë si një mirazh në shkretëtirë, të cilin i eturi e mendon për ujë. E kur mbërrin tek ai, nuk gjen asgjë; aty e gjen Allahun, atëherë, Ai ia jep llogarinë e tij plotësisht. Allahu është i shpejtë në llogari.

فِي بُيُوتٍ أُذِنَ لِلَّهِ أَنْ تُرْفَعَ وَيُذْكَرَ فِيهَا  
اسْمُهُ ۗ يُسَبِّحُ لَهُ فِيهَا بِالْغُدُوِّ وَالْآصَالِ ۗ

رَجَالٌ لَا تُلَّهُهُمُ تِجَارَةٌ وَلَا بَيْعٌ عَنْ  
ذِكْرِ اللَّهِ وَاقَامِ الصَّلَاةِ وَإِيتَاءِ الزَّكَاةِ  
يَخَافُونَ يَوْمًا تَتَقَلَّبُ فِيهِ الْقُلُوبُ  
وَالْأَبْصَارُ ۗ

لِيَجْزِيَ اللَّهُ أَحْسَنَ مَا عَمِلُوا وَيَزِيدَهُمُ  
مِّنْ فَضْلِهِ ۗ وَاللَّهُ يَرْزُقُ مَنْ يَشَاءُ بِغَيْرِ  
حِسَابٍ ۗ

وَالَّذِينَ كَفَرُوا أَعْمَالُهُمْ كَسَرَابٍ بِقِيَعَةٍ  
يَحْسَبُهُ الظَّمَانُ مَاءً ۗ حَتَّىٰ إِذَا جَاءَهُ لَمْ  
يَجِدْهُ شَيْئًا وَوَجَدَ اللَّهَ عِنْدَهُ فَوَفَّاهُ  
حِسَابَهُ ۗ وَاللَّهُ سَرِيعُ الْحِسَابِ ۗ

është për të gjithë njerëzit dhe nuk do të shuhet kurrë. Vaji i natyrës së tij është i gatshëm të ndizet vetë, qoftë pa e prekur zjarri, që do të thotë se edhe pa pasur shpalljen e Zotit, ai ishte dritë në shoqërinë ku jetonte. “Dritë mbi dritë”, pra pastaj një dritë qiellore si shpallja e Zotit ra mbi dritën e tij, gjë që e bëri burimin e të gjitha dritave. Këtu Zoti na tregoi edhe filozofinë e dritës Hyjnore se ajo bie atje ku ka dritë, e jo në zemra të errëta. Pra, duhet të kesh ngjashmëri me dritën Hyjnore, që të bekohesh prej saj, kurse errësira s’ka aspak ngjashmëri me dritën. Të gjithë Profetët janë ata, të cilëve për shkak të natyrshmërisë së tyre të pastër, iu dhurua drita Hyjnore dhe ata u bënë dritë e plotë.

Përveç kësaj, ky ajet paraqet edhe mënyrën si shpirti njerëzor mund të dritësohet përmes dritës Hyjnore. Këto janë të vërteta të përjetshme të gdhendura në natyrën e njeriut, me të cilat përfiton ai që tregohet i gatshëm për pastrimin shpirtëror dhe përpiket maksimalisht për ta arritur atë. Ky është spiritualizëm i vërtetë.

41. Ose (veprat e tyre) janë si errësira në një det të thellë, të cilin e kanë mbuluar dallgë mbi dallgë dhe mbi të edhe retë. Janë errësira njëra mbi tjetrën. Kur ai nxjerr dorën e tij, nuk arrin ta shohë atë. Atij që Allahu nuk i ka bërë dritë, për të nuk ka asnjë dritë.

42. A nuk e sheh se Allahun e lavdëron gjithkush që është në qiej e në tokë, dhe (edhe) zogjtë krahë-hapur?! Secili e ka ditur mënyrën e tij të adhurimit dhe të lavdërimit dhe Allahu është i Gjithëdijshëm për gjithçka që ata bëjnë.

43. I Allahut është sundimi i qiejve dhe i tokës dhe tek Allahu është kthimi.

44. A nuk e ke parë se pikërisht Allahu drejton renë, më pas e grumbullon dhe më pas e mbivendos njërin mbi tjetrën, dhe ti sheh shiun që bie përmes saj?! Ai lëshon breshër nga qielli, pra nga malet që gjenden në lartësi, dhe e lëshon mbi kë të dojë dhe e mban larg prej kujt të dojë. Shkëlqimi i vetëtimës së tij gati (ua) merr shikimin.

45. Allahu ndërron natën dhe ditën. Sigurisht, në këtë ka mësim për njerëzit që kanë sy.

46. Allahu krijoi përmes ujit çdo gjallesë që ecën. Prej tyre ka nga ato që ecin barkas, prej tyre ka nga ato që ecin në dy këmbë dhe prej tyre ka

أَوْ كُظِّلِمَتْ فِي جَرِّ لُجِّي يَحْشُهُ مَوْجٌ  
مِّنْ فَوْقِهِ مَوْجٌ مِّنْ فَوْقِهِ سَحَابٌ ط  
ظَلِمَتْ بَعْضُهَا فَوْقَ بَعْضٍ إِذَا أَخْرَجَ  
يَدَهُ لَمْ يَكِدْ يَرِبَهَا ط وَمَنْ لَّمْ يَجْعَلِ اللَّهُ  
لَهُ نُورًا فَمَا لَهُ مِنْ نُورٍ ①

أَلَمْ تَرَ أَنَّ اللَّهَ يَسِّحُ لَهُ مَنِ فِي السَّمَوَاتِ  
وَالْأَرْضِ وَالظَّيْرِ أَصْفَتْ ط كُلٌّ قَدْ عَلِمَ  
صَلَاتَهُ وَتَسْبِيحَهُ ط وَاللَّهُ عَلِيمٌ بِمَا  
يَفْعَلُونَ ②

وَاللَّهُ مَلِكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ٢ وَاللَّهُ  
الْمُصِيرُ ③

أَلَمْ تَرَ أَنَّ اللَّهَ يُرْجِي سَحَابًا ثُمَّ يُؤَلِّفُ  
بَيْنَهُ ثُمَّ يَجْعَلُهُ رُكَامًا فَتَرَى الْوَدْقَ  
يَخْرُجُ مِنْ خِلْفِهِ ٢ وَيُنزِلُ مِنَ السَّمَاءِ مِنْ  
جِبَالٍ فِيهَا مِنْ بَرَدٍ فَيُصِيبُ بِهِ مَنْ يَشَاءُ  
وَيَصْرِفُهُ عَنِ مَنْ يَشَاءُ ط يَكَادُ سَنَا بَرْقِهِ  
يَذْهَبُ بِالْأَبْصَارِ ④

يُقَلِّبُ اللَّهُ اللَّيْلَ وَالنَّهَارَ ط إِنَّ فِي ذَلِكَ لَعِبْرَةً  
لِّأُولِي الْأَبْصَارِ ⑤

وَاللَّهُ خَلَقَ كُلَّ دَابَّةٍ مِّنْ مَّاءٍ ٦ فَمِنْهُمْ مَنْ  
يَمْشِي عَلَى بَطْنِهِ ٦ وَمِنْهُمْ مَنْ يَمْشِي

edhe nga ato që ecin mbi të katrat. Allahu krijon çfarë të dojë. Sigurisht, Allahu është i Plotfuqishëm për gjithçka.

47. Pa dyshim, Ne zbritëm ajete të qarta. Allahu udhëzon kë të dojë në rrugën e drejtë.

48. Ata thonë: “Besuam në Allah dhe në të Dërguar dhe u bindëm”. Megjithatë, një grup prej tyre e kthen shpinën pas kësaj dhe këta kurrsesi nuk janë besimtarë.

49. Kur ata thirren drejt Allahut dhe të Dërguarit të Tij, që ai të vendosë mes tyre, një grup prej tyre papritmas shmangen.

50. Dhe nëse kanë ata të drejtë, vijjnë tek ai kokulur.

51. A kanë sëmundje në zemër apo kanë dyshime, apo kanë frikë se do t’u bëjnë padrejtësi Allahu dhe i Dërguari i Tij?! Përkundrazi, vetë ata janë të padrejtë.

52. Fjala e besimtarëve kur thirren drejt Allahut e të Dërguarit të Tij që të gjykohen mes njëri-tjetrit, është vetëm se thonë: “Ne dëgjuam dhe u bindëm”. Pikërisht këta janë të suksesshmit.

53. Dhe pikërisht ata që i binden Allahut e të Dërguarit të Tij, (që) i frikësohen Allahut dhe i druhen Atij, janë fitues.

عَلَىٰ رِجْلَيْنِ ۗ وَمِنْهُمْ مَّنْ يَّمْشِي عَلَىٰ  
أَرْبَعٍ ۚ يَخْلُقُ اللَّهُ مَا يَشَاءُ ۗ إِنَّ اللَّهَ عَلَىٰ  
كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿٤٧﴾

لَقَدْ أَنْزَلْنَا آيَاتٍ مُّبِينَاتٍ وَاللَّهُ يَهْدِي  
مَنْ يَشَاءُ إِلَىٰ صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ ﴿٤٨﴾

وَيَقُولُونَ آمَنَّا بِاللَّهِ وَبِالرَّسُولِ وَأَطَعْنَا  
ثُمَّ يَتَوَلَّىٰ فَرِيقٌ مِنْهُمْ مِّنْ بَعْدِ ذَلِكَ ۗ وَمَا  
أُولَٰئِكَ بِالْمُؤْمِنِينَ ﴿٤٩﴾

وَإِذَا دُعُوا إِلَى اللَّهِ وَرَسُولِهِ لِيَحْكُمَ بَيْنَهُمْ  
إِذَا فَرِيقٌ مِنْهُمْ مُّعْرِضُونَ ﴿٥٠﴾

وَإِنْ يَكُنْ لَهُمُ الْحَقُّ يَأْتُوا إِلَيْهِ مُذْعِنِينَ ﴿٥١﴾

أَفِي قُلُوبِهِمْ مَّرَضٌ أَمْ ارْتَابُوا أَمْ  
يَخَافُونَ أَنْ يَحْيِفَ اللَّهُ عَلَيْهِمْ وَرَسُولُهُ ۗ  
بَلْ أُولَٰئِكَ هُمُ الظَّالِمُونَ ﴿٥٢﴾

إِنَّمَا كَانَ قَوْلَ الْمُؤْمِنِينَ إِذَا دُعُوا إِلَى اللَّهِ  
وَرَسُولِهِ لِيَحْكُمَ بَيْنَهُمْ أَنْ يَقُولُوا سَمِعْنَا  
وَأَطَعْنَا ۗ وَأُولَٰئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ ﴿٥٣﴾

وَمَنْ يُطِيعِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَيَحْشِ اللَّهَ  
وَيَتَّقِهِ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْفَائِرُونَ ﴿٥٤﴾

54. Ata u betuan në Allah (dhe) i forcuan betimet e tyre që po t'i urdhërosh, ata patjetër do të dalin (për përballje). Thuaju: “Mos bëni be; (tregoni) bindje të denjë!” Allahu pa dyshim është i Informuar për gjithçka që bëni.

55. Thuaju: Bindjuni Allahut dhe bindjuni të Dërguarit. E nëse ktheheni, ai ka përgjegjësinë për aq sa është ngarkuar, dhe ju keni përgjegjësinë për aq sa jeni ngarkuar. E nëse do t'i bindeni, do të udhëzoheni. Kurse i Dërguari ka përgjegjësinë vetëm të kumtojë qartazi mesazhin.

56. Allahu u ka premtuar atyre prej jush që besuan dhe bënë të mira, se patjetër do t'i bëjë kalifë në tokë, ashtu siç i ka bërë kalifë ata që ishin para tyre dhe do t'ua përforcojë fenë që e ka pëlqyer për ta dhe do t'ua shndërrojë frikën në siguri. Ata do të më adhurojnë Mua dhe nuk do të barazojnë me Mua asgjë. Kurse ata që tregohen mosmirënjohës edhe pas kësaj, pikërisht ata janë të pabindur.<sup>8</sup>

وَأَقْسَمُوا بِاللَّهِ جَهْدَ أَيْمَانِهِمْ لَئِنْ  
أَمَرْتَهُمْ لَيَخْرُجْنَ ۗ قُلْ لَا تُفْسِمُوا طَاعَةَ  
مَعْرُوفَةَ ۗ إِنَّ اللَّهَ خَبِيرٌ بِمَا تَعْمَلُونَ ﴿٥٤﴾

قُلْ أَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ ۚ فَإِنْ تَوَلَّوْا  
فَأِنَّمَا عَلَيْهِ مَا حُمِّلَ وَعَلَيْكُمْ مَّا  
حُمِّلْتُمْ ۗ وَإِنْ تُصِيعُوهُ تَهْتَدُوا ۗ وَمَا عَلَى  
الرَّسُولِ إِلَّا الْبَلَاغُ الْمُبِينُ ﴿٥٥﴾

وَعَدَ اللَّهُ الَّذِينَ آمَنُوا مِنْكُمْ وَعَمِلُوا  
الصَّالِحَاتِ لَيَسْتَخْلِفَنَّهُمْ فِي الْأَرْضِ كَمَا  
اسْتَخْلَفَ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ ۗ وَلَيُمَكِّنَنَّ  
لَهُمْ دِينَهُمُ الَّذِي ارْتَضَى لَهُمْ وَلَيُبَدِّلَنَّهُمْ  
مِنْ بَعْدِ خَوْفِهِمْ أَمْنًا ۗ يَعْبُدُونَنِي لَا  
يُشْرِكُونَ بِي شَيْئًا ۗ وَمَنْ كَفَرَ بَعْدَ ذَلِكَ  
فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْفَاسِقُونَ ﴿٥٦﴾

8. *Kalif* do të thotë mëkëmbës, pasardhës. Ky ajet quhet “*ajeti istikhlaf*”, në të cilin thuhet se Allahu i Madhërishtëm, ashtu siç vendosi kalifatit pas Profetëve të mëparshëm, do ta vendoste atë edhe pas Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, dhe ky kalifat do ta mbartte edhe më tej pikërisht dritën profetike. Gjithashtu, sa herë që do të largohet nga kjo botë ndonjë kalif, xhemati i besimtarëve do të përballtet me një frikë se mos armiku do ta shuajë dritën Hyjnore, por ky ajet i sures En-Nur jep premtimin e fortë se në saje të bekimit të Zotit të Madhërishtëm përmes kalifatit, çdoherë armiku do të dështojë dhe frika do të kthehet sërish në siguri. Kjo do të jetë edhe shenjë e kalifatit të vërtetë që ai do ta nxjerrë xhematin e besimtarëve nga frika në siguri. Qëllimi i profetërisë është vendosja e njëshmërisë së Zotit në tokë. Kështu që, një tjetër shenjë e kalifatit të vërtetë është se edhe qëllimi i tij përfundimtar do të jetë vendosja e njëshmërisë së Zotit. Edhe Profeti Muhammed<sup>savs</sup> parashikoi se umeti i tij do ta gëzojë Kalifatit në rrugën e profetërisë jo vetëm menjëherë pas tij, por edhe në një kohë të dytë (Musned Ahmed, vell.



57. Lartësoni namazin, jepni zekatin dhe bindjuni të Dërguarit, që të mëshiroheni.

58. Kurrsesi mos mendo se ata që mohuan të mund të (Na) mposhtin në tokë. Streha e tyre është zjarri. Sa destinacion i keq është ai!

59. O ju që besuat! Ata që janë në zotërimin tuaj, dhe prej jush ata që nuk e kanë arritur pjekurinë, le t'ju kërkojnë leje gjatë tri kohëve (përpara se të hyjnë në dhomat tuaja të gjumit): përpara namazit të sabahut, gjatë drekës kur zhvishni rrobat tuaja për të pushuar, si dhe pas namazit të jacisë. Këto janë tri kohë intime për ju. Nuk bëni gjynah as ju e as ata pas këtyre (kohëve). Disa prej jush hyjnë e dalin te disa të tjerë. Kështu Allahu ju shpjegon qartë ajetet. Allahu është i Gjithëdijshëm, i Urtë.<sup>9</sup>

60. E kur fëmijët tuaj të arrijnë pjekurinë, le t'ju kërkojnë leje, siç kërkonin leje ata që ishin para tyre. Kështu Allahu ju shpjegon qartë ajetet e Tij. Allahu është i Gjithëdijshëm, i Urtë.

وَأَقِيمُوا الصَّلَاةَ وَآتُوا الزَّكَاةَ وَاطِيعُوا  
الرَّسُولَ لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ ﴿٥٧﴾

لَا تَحْسَبَنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا مُعْجِزِينَ فِي  
الْأَرْضِ ۗ وَمَأْوَهُمُ النَّارُ وَلَيْسَ  
بِالْمَصِيرِ ﴿٥٨﴾

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لِيَسْتَأْذِنَكُمْ الَّذِينَ  
مَلَكَتْ أَيْمَانُكُمْ وَالَّذِينَ لَمْ يَبْلُغُوا الْحُلُمَ  
مِنْكُمْ ثَلَاثَ مَرَّاتٍ ۖ مِنْ قَبْلِ صَلَاةِ الْفَجْرِ  
وَحِينَ تَضَعُونَ ثِيَابَكُمْ مِنَ الظَّهِيرَةِ  
وَمِنْ بَعْدِ صَلَاةِ الْعِشَاءِ ۚ ثَلَاثُ عَوْرَاتٍ لَكُمْ ۖ  
لَيْسَ عَلَيْكُمْ وَلَا عَلَيْهِمْ جُنَاحٌ بَعْدَهُنَّ  
طَوْفُونَ عَلَيْكُمْ بَعْضُكُمْ عَلَى بَعْضٍ ۖ  
كَذَلِكَ يُبَيِّنُ اللَّهُ لَكُمْ الْآيَاتِ ۗ وَاللَّهُ عَلِيمٌ  
حَكِيمٌ ﴿٥٩﴾

وَإِذَا بَلَغَ الْأَطْفَالُ مِنْكُمْ الْحُلُمَ  
فَلْيَسْتَأْذِنُوا كَمَا اسْتَأْذَنَ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ ۖ  
كَذَلِكَ يُبَيِّنُ اللَّهُ لَكُمْ آيَاتِهِ ۗ وَاللَّهُ عَلِيمٌ  
حَكِيمٌ ﴿٦٠﴾

6, f. 285; Musned En-Numan Ibni Beshir, nr. i hadithit 18596, Bejrut, 1998). Duket e qartë se për shkak të këtij ajeti që flet për kalifatin ose udhëheqjen e besimtarëve, në ajetet 52 – 55 theksi është vënë në mënyrë të përsëritur tek bindja ndaj Allahut dhe ndaj të Dërguarit të Tij. Ky theksim hedh dritë mbi statusin dhe pozitën e një Kalifi në Islam. Sot Xhemati Musliman Ahmedia është ajo bashkësi muslimane, e cila me bekimin e Zotit gëzon Kalifatin. Më shumë për këtë temë, mund të lexoni librin e Hazret Mirza Ghulam Ahmedit<sup>as</sup>, të titulluar “Testamenti”, botuar në Prishtinë, 2011.

9. Ky ajet, sikurse disa ajete të tjera të kësaj sureje, u mëson besimtarëve një element për ta ruajtur privatësinë e tyre. Shërbyesit, si dhe fëmijët e mitur duhet t'i mësojnë të kërkojnë leje para se të futen në dhomat e të rriturve në këto tri kohë.

61. Dhe gratë e moshuara që nuk shpresojnë më për martesë, nuk kanë gjynah nëse i heqin rrobat e tyre (pra, mbulesën), pa qenë të zbukuruara; e nëse përmbahen, është më mirë për to. Allahu është Gjithëdhëgjues, i Gjithëdijshëm.

62. Nuk është gjynah për të verbrin, nuk është gjynah për të çalin, nuk është gjynah as për të sëmurin dhe as për ju, që të hani në shtëpitë tuaja, ose në shtëpitë e baballarëve tuaj, ose në shtëpitë e nënave tuaja, ose në shtëpitë e vëllezërve tuaj, ose në shtëpitë e motrave tuaja, ose në shtëpitë e xhaxhallarëve tuaj, ose në shtëpitë e hallave tuaja, ose në shtëpitë e dajave tuaj, ose në shtëpitë e tezeve tuaja, ose në atë (shtëpi), së cilës i zotëroni ju çelësat, ose në (shtëpitë e) miqve tuaj. Nuk është gjynah për ju të hani bashkërisht a të ndarë. Kur hyni në ndonjë shtëpi, përshëndetini me selam njerëzit tuaj; është dhuratë prej Allahut, e bekuar dhe e pastër. Kështu Allahu ju shpjegon qartë ajetet, që të kuptoni.

63. Sigurisht, besimtarët janë ata që besuan Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe që kur janë me të për (të diskutuar) një çështje të përbashkët, nuk largohen derisa nuk i kërkojnë leje atij. Pikërisht ata që të kërkojnë leje ty, besojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Kështu që, kur të kërkojnë leje për ndonjë punë të tyre, lejo kë të duash prej tyre dhe kërkoji falje Allahut për ta. Pa dyshim,

وَالْفَوَاعِدُ مِنَ النِّسَاءِ الَّتِي لَا يَرَجُونَ نِكَاحًا فَلَيْسَ عَلَيْهِنَّ جُنَاحٌ أَنْ يَضَعْنَ ثِيَابَهُنَّ غَيْرَ مُتَبَرِّجَاتٍ بِزِينَةٍ وَأَنْ يَسْتَعْفِفْنَ خَيْرٌ لَّهُنَّ وَاللَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ ﴿٦١﴾

لَيْسَ عَلَى الْأَعْمَى حَرَجٌ وَلَا عَلَى الْأَعْرَجِ حَرَجٌ وَلَا عَلَى الْمَرِيضِ حَرَجٌ وَلَا عَلَى أَنْفُسِكُمْ أَنْ تَأْكُلُوا مِنْ بُيُوتِكُمْ أَوْ بُيُوتِ آبَائِكُمْ أَوْ بُيُوتِ أُمَّهَاتِكُمْ أَوْ بُيُوتِ إِخْوَانِكُمْ أَوْ بُيُوتِ أَخَوَاتِكُمْ أَوْ بُيُوتِ أَعْمَامِكُمْ أَوْ بُيُوتِ عَمَّاتِكُمْ أَوْ بُيُوتِ أَخَوَاتِكُمْ أَوْ بُيُوتِ حُلُمِكُمْ أَوْ مَا مَلَكَتْ أَيْمَانُكُمْ فَمَفَاحٍ أَوْ صَدِيقِكُمْ لَيْسَ عَلَيْكُمْ جُنَاحٌ أَنْ تَأْكُلُوا جَمِيعًا أَوْ أَشْتَاتًا فَإِذَا دَخَلْتُمْ بُيُوتًا فَسَلِّمُوا عَلَى أَنْفُسِكُمْ تَحِيَّةً مِنْ عِنْدِ اللَّهِ مُبْرَكَةٌ طَيِّبَةٌ كَذَلِكَ بَيِّنٌ لِّلَّذِينَ لَعَلَّكُمْ تَعْقِلُونَ ﴿٦٢﴾

إِنَّمَا الْمُؤْمِنُونَ الَّذِينَ آمَنُوا بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ وَإِذَا كَانُوا مَعَهُ عَلَى أَمْرٍ جَامِعٍ لَمْ يَذْهَبُوا حَتَّى يَسْأَلُوهُ إِنْ الَّذِينَ يَسْأَلُونَكَ أُولَئِكَ الَّذِينَ يُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ فَإِذَا اسْأَلْتَهُمْ لِبَعْضِ شَأْنِهِمْ فَأَذَنَ لِمَنْ شِئْتَ مِنْهُمْ وَاسْتَغْفَرَ لَهُمُ اللَّهُ إِنَّ اللَّهَ

Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

عَفُورٌ رَّحِيمٌ ﴿١٧﴾

64. Thirrjen e të Dërguarit ndaj jush mos e merrni sikur thirrjen (tuaj) ndaj njëri-tjetrit mes jush. Allahu i di mirë ata që përvidhen tinëz prej jush. Pra, ata që e kundërshtojnë urdhrin e Tij, le të kenë frikë të mos i zërë ndonjë sprovë ose t'i kapë një ndëshkim i dhimbshëm.

لَا تَجْعَلُوا دُعَاءَ الرَّسُولِ بَيْنَكُمْ كَدَعَاءِ  
بَعْضِكُمْ بَعْضًا قَدْ يَعْلَمُ اللَّهُ الَّذِينَ  
يَسْتَلْتُونَ مِنْكُمْ لِيُحَذِّرَ الَّذِينَ  
يُخَالِفُونَ عَنْ أَمْرِهِ أَنْ تُصِيبَهُمْ فِتْنَةٌ  
أَوْ يُصِيبَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿١٧﴾

65. Dëgjoni! E Allahut është gjithçka që gjendet në qiej e tokë. Ai e di në çfarë (gjendje) jeni. Ditën kur ata do të kthehen tek Ai, atëherë Ai do t'i informojë për atë që bënin. Allahu është i Gjithëdijshëm për çdo gjë.

أَلَا إِنَّ لِلَّهِ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ  
قَدْ يَعْلَمُ مَا أَنْتُمْ عَلَيْهِ وَيَوْمَ يُرْجَعُونَ  
إِلَيْهِ فَيُنَبِّئُهُمْ بِمَا عَمِلُوا وَاللَّهُ بِكُلِّ  
شَيْءٍ عَلِيمٌ ﴿١٨﴾

## Surja 25 – El-Furkan

Surja El-Furkan zbriti në fund të periudhës mekase. Bashkë me *bismil-lahin* ajo ka shtatëdhjetë e tetë ajete.

Kjo sure hap temën duke pohuar se Allahu i Madhërishëm i ka dhënë Profetit Muhammed<sup>savs</sup> *dallimin* (*furkanin*) e madh, i cili do ta bëjë të qartë të vërtetin nga gënjeshtari. Ky është i njëjti kriter dallues që u fol vijueshëm në suren paraardhëse. Kjo sure sjell shembuj të rinj të tij.

Profeti Muhammed<sup>savs</sup> kishte aftësi jo vetëm të dallohej mes njerëzve që e rrethonin, madje atij i është dhënë një kriter i fuqishëm në formën e Kuranit për të dalluar të vërtetët dhe gënjeshtarët e të gjithë botës.

Kur shikonin mrekullitë shpirtërore të jashtëzakonshme të Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, kundërshtarët nga ana e tyre paraqisnin si kriter duke pyetur:

“Çfarë ndodhi me këtë Profet, që ha, pi, shëtit nëpër rrugë e sheshe?! Përse nuk shoqërohet me ndonjë engjell të ardhur nga qielli, që edhe ai t’u fliste njerëzve?! Përse nuk solli prej qiellit ndonjë thesar që do t’i lante ata me flori?!”

Ndërsa e vërteta është që të Dërguarit të Zotit i zbret thesari i paçmueshëm i mësimave Hyjnore, dhe jo ndonjë thesar fizik siç pretendojnë kundërshtarët e tij.

Po kështu, kundërshtarët e Profetit Muhammed<sup>savs</sup> kërkojnë që ai duhet të kishte kopshte e pemishte pafund, që ai të hante nga të donte e sa të donte. Duke iu përgjigjur këtij mendimi, Allahu i Madhërishëm i thotë Profetit<sup>savs</sup>:

Kopshtet që Ne kemi përgatitur për ty në xhenet dhe kështjellat shpirtërore që Ne kemi ngritur për ty atje, këta të paditurit as nuk mund t’i imagjinojnë dot!

Duke iu drejtuar mohuesve, Zoti i Madhërishëm kërkon: Tregoni qoftë një shembull, që i Dërguari i Zotit të mos kishte qenë një njeri i thjeshtë dhe që nuk ecte nëpër rrugë si gjithë njerëzit e tjerë! E nëse mohuesit nuk arrijnë ta tregojnë, ata po e mohojnë praktikën e Zotit që Ai zgjedh të Dërguarit e Tij nga njerëzit.

Për sa i përket kërkesës së mohuesve që edhe atyre t’u zbresin engjëjt, Kurani thotë se atyre patjetër do t’u zbresin engjëjt, por me lajmin e vdekjes dhe të ndëshkimit, nga i cili nuk do të gjejnë më shpëtim.

Kjo sure citon edhe një kundërshtim tjetër të mohuesve se përse Kurani i Shenjtë nuk u zbriti i gjithi përnjëherë. Në të vërtetë urtësi të shumta fshihen në moszbritjen e tij përnjëherë. Rrethanat kërkonin që ajetet Kuranore të zbriteshin duke trajtuar “sëmundjet e mohuesve” që shfaqeshin në mënyrë të njëpasnjëshme. Së dyti, çdoherë shenjat Hyjnore t’ia përforconin zemrën Profetit Muhammed<sup>savs</sup> edhe më shumë dhe kështu, Profeti<sup>savs</sup> të shikonte jo një, por pafund shenja Hyjnore gjatë gjithë kohëzgjatjes së zbritjes së Kuranit.

Gjithashtu, Kurani i zbritur përgjatë njëzet e tri viteve, që ka një elokuencë dhe renditje të

mahnitshme, tregon edhe të vërtetën se për Profetin Muhammed<sup>savs</sup> kjo punë ishte e pamundur, sepse njerëzit, sidomos Profeti<sup>savs</sup> që nuk dinte shkrim e këndim, nuk mund t'i përfshijnë të gjitha temat njëzetetrevjeçare në kujtesën e tyre, pa pasur kontradiktë ose mospërputhje mes tyre.

Përveç kësaj, *Hazret Mesihu i Premtuar*<sup>as</sup> na tërheq vëmendje edhe te një urtësi tjetër. Gjatë gjithë periudhës njëzetetrevjeçare, i Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> u përball me rreziqe shumë të mëdha. Luftoi me armikun duke dalë para sahabëve në rrethana vdekjeprurëse. Iu bënë tentativa për ta vrarë edhe me helmim. Megjithatë, Zoti i Madhërisëm i dha jetë derisa u kompletua i gjithë Sheriati. Në këtë mënyrë, zbritja e ngadalshme e Kuranit të Shenjtë në vetvete është një mrekulli madhështore.

Në fund, kjo sure flet për shenjat e *robërve të të Gjithëmëshirshmit*, por para kësaj flet edhe për yjësitë në qiell, që janë dymbëdhjetë, më pas flet për një diell dhe një hënë të ndritur, që tregojnë se Profeti Muhammed<sup>savs</sup> si dielli shpirtëror do të kishte dymbëdhjetë reformatorë në *umetin* e tij dhe gjithashtu një hënë të plotë, të ndriçuar tërësisht nga drita e diellit, ku të gjitha bashkë do ta ndriçonin *umetin* e tij në errësira.

Pas kësaj, duke renditur cilësitë e robërve të të Gjithëmëshirshmit, thotë se ata ndjekin rrugën e mesme në jetë, janë të përlulur, kalojnë jetën duke qëndruar në këmbë dhe duke bërë sexhde përpara Zotit të tyre, virtyte të cilat u sigurojnë çdo bekim e çdo epërsi. Ajeti i fundit i kësaj sureje flet se ata kalojnë jetën duke qëndruar në këmbë dhe duke bërë sexhde përpara Zotit për arsye se nuk ka asnjë mjet për të fituar jetën prej Zotit përveç lutjes dhe, prandaj, ata që e mohojnë lutjen dhe shkëpusin lidhjen me Zotin e Madhërisëm, do t'u ngjiten pashmangshmërisht "sëmundje" të panumërta shpirtërore për të mos u larguar më prej tyre.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Zotëruesi i bekimit është Ai që zbriti dalluesin mbi robin e Tij, që ai të jetë alarmues për botët.

تَبَارَكَ الَّذِي نَزَّلَ الْفُرْقَانَ عَلَى عَبْدِهِ لِيَكُونَ لِلْعَالَمِينَ نَذِيرًا ①

3. Ai që ka sundimin e qiejve dhe të tokës, që nuk ka marrë bir dhe as nuk ka ndonjë ortak në sundim dhe krijoi çdo gjë duke e përcaktuar me masën e duhur.

الَّذِي لَهُ مُلْكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَلَمْ يَتَّخِذْ وَلَدًا وَ لَمْ يَكُنْ لَهُ شَرِيكٌ فِي الْمُلْكِ وَخَلَقَ كُلَّ شَيْءٍ فَقَدَرَهُ تَقْدِيرًا ①

4. Duke e lënë Atë, ata sajuan të adhurueshëm të tjerë që nuk krijojnë asgjë, madje vetë janë të krijuar dhe nuk kanë fuqi t'i sjellin vetes as dëm e as dobi, dhe nuk kanë në sundim as vdekjen, as jetën e as ringjalljen.

وَ اتَّخَذُوا مِنْ دُونِهِ آلِهَةً لَا يَخْلُقُونَ شَيْئًا وَ هُمْ يُخْلَقُونَ وَ لَا يَمْلِكُونَ لِأَنْفُسِهِمْ ضَرًّا وَ لَا نَفْعًا وَ لَا يَمْلِكُونَ مَوْتًا وَ لَا حَيَوَةً وَ لَا نُسُورًا ①

5. Ata që mohuan thanë: “Kjo është thjesht një gënjeshtër që ai e sajoi, dhe për këtë, atë e ndihmuan edhe njerëz të tjerë!” Kështu ata bënë padrejtësi dhe (sajuan) gënjeshtër!<sup>1</sup>

وَ قَالَ الَّذِينَ كَفَرُوا إِنْ هَذَا إِلَّا آفَاكٌ أَفْتَرَاهُ وَ أَعَانَهُ عَلَيْهِ قَوْمٌ آخَرُونَ فَقَدْ جَاءُوا ظُلْمًا وَ زُورًا ①

1. Shumë nga hebrenjtë dhe të krishterët e kohës së Profetit Muhammed<sup>savs</sup> ishin ziliqarë nga fakti se përse Profeti i premtuar nuk erdhi nga gjiri i tyre, por erdhi nga bijtë e Ismailit, pavarësisht se e kishin lexuar profecinë se ai nuk do të vinte nga Bijtë e Izraelit, por nga gjiri i vëllezërve të tyre (Bibla, Ligji i Përtërirë 18:18). Po kështu, edhe Profeti që erdhi ishte i pashkolluar. Duke parë se ai po shpërndante urtësi të thella, pra Kurani e Shenjtë, ata nuk arrinin të besonin se kjo punë të kryhej nga një njeri i vetëm si Profeti Muhammed<sup>savs</sup>. Andaj, thurën akuza se jo një a dy persona, por një popull i tërë po e ndihmonte atë. Kurse ata që ishin të ditur dhe të mençur prej tyre, e dinin se Kurani i Shenjtë është thjesht përtej fuqisë njerëzore, dhe këta të fundit e pranuan Kurani me një besim kaq të palëkundur, saqë për ta Zoti thotë: “ata ... e njohin këtë ashtu siç i njohin bijtë e tyre” (2:147).

6. Dhe thanë: “Janë përrallat e të parëve që dikush ia shkroi, dhe atij i lexohen ato ditë e natë.”

وَقَالُوا أَسَاطِيرُ الْأَوَّلِينَ اكْتَتَبَهَا فَهِيَ  
تُمْلَى عَلَيْهِ بُكْرَةً وَأَصِيلًا ①

7. Thuaj: Këtë e zbriti Ai që di të fshehtën e qiejve dhe të tokës. Pa dyshim, Ai është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

قُلْ أَنْزَلَهُ الَّذِي يَعْلَمُ السِّرَّ فِي السَّمَوَاتِ  
وَالْأَرْضِ إِنَّكَ كَانَ غَفُورًا رَحِيمًا ②

8. Dhe thanë: “Çfarë ka ky i Dërguar që ha ushqim dhe ecën nëpër pazare?! Përse nuk iu zbrit ndonjë engjëll, i cili të qëndronte bashkë me të e të ishte alarmues (për njerëzit)?!

وَقَالُوا مَا لِي هَذَا الرَّسُولِ يَأْكُلُ الطَّعَامَ  
وَيَمْشِي فِي الْأَسْوَاقِ لَوْلَا أَنْزَلَ إِلَيْهِ  
مَلَكٌ فَيَكُونُ مَعَهُ نَذِيرًا ③

9. Ose t'i vinte ndonjë thesar, ose të kishte ndonjë kopsht, nga i cili ai të ushqejtë!” Dhe të padrejtët thanë: “Ju shkoni veçse pas një njeriu të magjepsur!”

أَوْ يُلْقَى إِلَيْهِ كَنْزٌ أَوْ تَكُونُ لَهُ جَنَّةٌ  
يَأْكُلُ مِنْهَا وَقَالَ الظَّالِمُونَ إِنْ تَتَّبِعُونَ إِلَّا  
رَجُلًا مَسْحُورًا ④

10. Shih se çfarë shembujsh japin për ty! Kështu që, ata kanë devijuar dhe nuk gjejnë dot rrugë.

أَنْظُرْ كَيْفَ صَرَبُوا لَكَ الْأَمْثَالَ فَضَلُّوا  
عَجَبًا فَلَا يَسْتَطِيعُونَ سَبِيلًا ⑤

11. Zotëruesi i bekimit është Ai, që nëse do, bën për ty diçka më të mirë se këto, kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe pallate madhështore.

تَبَارَكَ الَّذِي إِنْ شَاءَ جَعَلَ لَكَ خَيْرًا  
مِّنْ ذَلِكَ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ  
وَيَجْعَلُ لَكَ قُصُورًا ⑥

12. Në të vërtetë ata e mohuan fare Orën (pra Kiametin) dhe për ata që mohojnë Orën, Ne kemi përgatitur një zjarr flakërues.

بَلْ كَذَّبُوا بِالسَّاعَةِ ۖ وَأَعْتَدْنَا لِمَنْ كَذَبَ  
بِالسَّاعَةِ سَعِيرًا ⑦

13. Kur ai (zjarr) do t'i shohë ata që nga një vend i largët, ata do të dëgjojnë zemëratën dhe ulërimën e tij.

إِذَا رَأَتْهُمْ مِنْ مَّكَانٍ بَعِيدٍ سَمِعُوا لَهَا  
تَغَيُّطًا وَزَفِيرًا ⑧

14. E kur do të hidhen në të, të prangosur në një vend të ngushtë, atëherë do ta thërrasin vdekjen.

وَإِذَا أُلْقُوا مِنْهَا مَكَانًا ضَيِّقًا مُّقَرَّنِينَ  
دَعَوْا هُنَالِكَ ثُبُورًا<sup>١٤</sup>

15. “Sot mos thirrni veç një vdekje, por thirrni vdekje të shumta!”

لَا تَدْعُوا الْيَوْمَ ثُبُورًا وَاحِدًا وَ اَدْعُوا  
ثُبُورًا كَثِيرًا<sup>١٥</sup>

16. Pyet: Më mirë kjo apo xheneti i përjetshëm që u premtohet atyre që kanë druajtje (ndaj Zotit), (vend i cili) do të jetë për ta si shpërblim dhe si kthim?!

قُلْ أَذَلِكَ خَيْرٌ أَمْ جَنَّةُ الْخُلْدِ الَّتِي وُعِدَ  
الْمُتَّقُونَ<sup>١٦</sup> كَانَتْ لَهُمْ جَزَاءً وَوَمَصِيرًا<sup>١٦</sup>

17. Ata do të kenë në të gjithçka që dëshirojnë. Ky është një premtim i sigurt që ka marrë përsipër Zoti yt.

لَهُمْ فِيهَا مَا يَشَاءُونَ خُلْدِينَ<sup>١٧</sup> كَانَ عَلَى  
رَبِّكَ وَعْدًا مَسْئُولًا<sup>١٧</sup>

18. Dhe ditën kur Ai do t'i tubojë këta dhe ata që këta i adhuronin përveç Allahut, atëherë do t'i pyesë: “A ju i keni devijuar robërit e Mi apo ata vetë kanë devijuar nga rruga?”

وَيَوْمَ يَحْشُرُهُمْ وَمَا يَعْبُدُونَ مِنْ دُونِ  
اللَّهِ فَيَقُولُ ءَأَنْتُمْ أَصَلَلْتُمْ عِبَادِي هَؤُلَاءِ  
أَمْ هُمْ صَلُّوا السَّبِيلَ<sup>١٨</sup>

19. Ata do të thonë: “I Shenjtë je Ti! Nuk na takon të marrim mbrojtës të tjerë përveç Teje, por Ti i begatove ata dhe baballarët e tyre, gjersa harruan kujtimin (Tënd) dhe u bënë popull që shkatërrohet.”

قَالُوا سُبْحَانَكَ مَا كَانَ يَدْبِجِي لَنَا أَنْ نَتَّخِذَ  
مِنْ دُونِكَ مِنْ أَوْلِيَاءَ وَلَكِنْ مَتَّعْتَهُمْ  
وَآبَاءَهُمْ حَتَّى نَسُوا الذِّكْرَ<sup>١٩</sup> وَكَانُوا قَوْمًا  
بُورًا<sup>١٩</sup>

20. Pra, (do t'u thuhet mohuesve): Ata jua kanë përgënjeshtuar atë që thoni, andaj, nuk keni më mundësi as për të shtyrë (ndëshkimin), e as të gjeni ndihmë. Prej jush ai që bën padrejtësi, Ne do ta bëjmë të shijojë një ndëshkim të madh.

فَقَدْ كَذَّبْتُمْ بِمَا تَقُولُونَ<sup>٢٠</sup> لِمَا تَسْتَطِيعُونَ  
صِرَافًا وَ لَا نَصْرًا<sup>٢٠</sup> وَمَنْ يَظْلِمِ مِنْكُمْ  
نُذِقْهُ عَذَابًا كَبِيرًا<sup>٢٠</sup>



21. Edhe të Dërguarit që kemi dërguar para teje, hanin ushqim dhe ecnin nëpër pazare.<sup>2</sup> Disa prej jush Ne i bëmë sprovë për disa të tjerë. A do të duroni? Zoti yt është Gjithëshikues.

وَمَا أَرْسَلْنَا قَبْلَكَ مِنَ الْمُرْسَلِينَ إِلَّا إِنَّهُمْ  
يَأْكُلُونَ الطَّعَامَ وَيَمْشُونَ فِي الْأَسْوَاقِ<sup>ط</sup>  
وَجَعَلْنَا بَعْضَكُمْ لِبَعْضٍ فِتْنَةً<sup>ط</sup> أَتَصْبِرُونَ<sup>ج</sup>  
وَكَانَ رَبُّكَ بَصِيرًا<sup>١١</sup>

Xhuzi 19

22. Ata që nuk shpresojnë takimin Tonë, thanë: “Përse nuk na zbresin engjëjt (edhe) neve, ose ne ta shihnim Zotin tonë?!” Njëmend, ata u ndienë mendjemëdhenj në veten e tyre dhe bënë rebelim të madh.

وَقَالَ الَّذِينَ لَا يَرْجُونَ لِقَاءَنَا لَوْلَا  
أَنْزَلْ عَلَيْنَا الْمَلِيكََةَ أَوْ نَرَى رَبَّنَا<sup>ط</sup> لَقَدْ  
اسْتَكْبَرُوا فِي أَنْفُسِهِمْ وَعَتَوْا عُتُوًّا كَبِيرًا<sup>١١</sup>

23. Ditën kur ata do t'i shohin engjëjt, atë ditë nuk do të ketë asnjë lajm të mirë për fajtorët, ata do të thonë: “Larg qofshim (nga engjëjt e ndëshkimit)!”

يَوْمَ يَرُونَ الْمَلِيكََةَ لَا بُشْرَى يَوْمَئِذٍ  
لِلْمُجْرِمِينَ وَيَقُولُونَ حِجْرًا مَحْجُورًا<sup>١١</sup>

24. Ne do t'i dalim përpara çdo vepre që kanë bërë e më pas, atë do ta bëjmë pluhur të shpërndarë.

وَقَدِمْنَا إِلَى مَا عَمِلُوا مِنْ عَمَلٍ فَجَعَلْنَاهُ  
هَبَاءً مَّنْثُورًا<sup>١٢</sup>

25. Banorët e xhenetit atë ditë do të kenë qëndrim të mbarë dhe pushim të këndshëm.

أَصْحَابُ الْجَنَّةِ يَوْمَئِذٍ خَيْرٌ مُّسْتَقَرًّا وَ  
أَحْسَنُ مَقِيلًا<sup>١٣</sup>

26. Ditën kur qielli do të çahet nga (bubullimat dhe) retë dhe engjëjt do të zbresin grupe-grupe.

وَيَوْمَ تَشَقَّقُ السَّمَاءُ بِالْغَمَامِ وَنُزِّلَ  
الْمَلِيكََةُ تَنْزِيلًا<sup>١٤</sup>

27. Sundimi i vërtetë atë ditë do të jetë i të Gjithëmëshirshmit. Dhe për mohuesit ajo do të jetë një ditë e rëndë.

الْمَلِكُ يَوْمَئِذٍ الْحَقُّ لِلرَّحْمَنِ<sup>ط</sup> وَكَانَ  
يَوْمًا عَلَى الْكٰفِرِينَ عَسِيرًا<sup>١٥</sup>

2. Lexoni 21:9.

28. Ditën kur keqbërësi do t'i kafshojë duart e tij (nga dëshpërimi e) do të thotë: “Ah, sikur të kisha zgjedhur rrugën bashkë me të Dërguarin!

وَيَوْمَ يَعْصُ الظَّالِمُ عَلَى يَدَيْهِ يَقُولُ  
لِيَتَّيَنِي أَخَذْتُ مَعَ الرَّسُولِ سَبِيلًا ﴿٢٨﴾

29. Mjerë unë! Ah sikur të mos e kisha bërë filanin shok!

يَوَيْلٌ لِيَتَّيَنِي لِمَ أَخَذْتُ فَأُلَانًا حَبِيلًا ﴿٢٩﴾

30. Njëmend, ai më largoi nga përkujtimi (i Zotit), pasi më kishte ardhur!” Djalli për njeriun është dëshpërues.

لَقَدْ أَصَلَّنِي عَنِ الذِّكْرِ بَعْدَ إِذْ جَاءَنِي ۗ  
وَكَانَ الشَّيْطَانُ لِلْإِنْسَانِ خَذُولًا ﴿٣٠﴾

31. Dhe i Dërguari tha: “O Zoti im! Populli im e ka braktisur këtë Kuran!”<sup>3</sup>

وَقَالَ الرَّسُولُ يَا رَبِّ إِنَّ قَوْمِي اتَّخَذُوا  
هَذَا الْقُرْآنَ مَهْجُورًا ﴿٣١﴾

32. Dhe kështu për çdo profet bëmë armiq nga fajtorët. Zoti yt është i mjaftueshëm si Udhëzues dhe Ndihmës.

وَكَذَلِكَ جَعَلْنَا لِكُلِّ نَبِيٍّ عَدُوًّا مِّنَ  
الْمُجْرِمِينَ ۗ وَكَفَىٰ بِرَبِّكَ هَادِيًّا  
وَنَصِيرًا ﴿٣٢﴾

33. Dhe ata që mohuan, thanë: “Atij pse nuk iu zbrit Kurani i gjithi përnjëherë?” Kështu (duhej), që të të forcojmë ty zemrën përmes tij dhe (gjithashtu) Ne e renditëm bukur e të vendosur.<sup>4</sup>

وَقَالَ الَّذِينَ كَفَرُوا لَوْلَا نُزِّلَ عَلَيْهِ  
الْقُرْآنُ جُمْلَةً وَاحِدَةً ۗ كَذَلِكَ لِنُثَبِّتَ بِهِ  
فُؤَادَكَ وَرَتَّلْنَاهُ تَرْتِيلًا ﴿٣٣﴾

3. Ky ajet, pa dyshim, nuk flet për sahabët e Profetit, Allahu qoftë i kënaqur me ta, sepse ata gjatë jetës së Profetit<sup>savs</sup>, madje *tabeinët* dhe ata që erdhën më vonë deri në treqind vjet, nuk e braktisën Kuranin. Kjo duhet të ishte një profeci që do të përmbushej në të ardhmen, kur *umeti* i Profetit<sup>savs</sup> praktikisht do ta braktiste Kuranin, dhe i Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> për këtë do të ankohej para Allahut të Madhërishëm.

4. Zoti e zbriti Kuranin pjesë-pjesë, në mënyrë që muslimanët jo vetëm që të njiheshin gradualisht me porosinë e Hyjnore, por edhe ta mësonin përmendsh gjithë Kuranin, dhe së dyti, shpesh shpalljet sillnin profeci të ndryshme, dhe suret pasardhëse u referoheshin atyre profecive që përmbusheshin, dhe kjo ia forconte besimin edhe Profetit<sup>savs</sup>, edhe sahabëve të tij. Po të ishte zbritur Kurani përnjëherë, nuk do të arriheshin këto qëllime.

34. Çdoherë kur ata të vijnë me ndonjë çështje, Ne të sjellim të vërtetën dhe interpretimin më të bukur.

وَلَا يَأْتُونَكَ بِمَثَلٍ إِلَّا جِئْنَاكَ بِالْحَقِّ  
وَأَحْسَنَ نَفْسِيرًا ۝٣٤

35. Ata që për fytyrash do të sillen pranë xhehenemit; këta janë pikërisht më të këqijtë për nga pozita, dhe më të devijuarit nga rruga.

الَّذِينَ يُحْشِرُونَ عَلَىٰ وُجُوهِهِمْ إِلَىٰ  
جَهَنَّمَ ۗ أُولَٰئِكَ شَرٌّ مَكَانًا وَأَضَلُّ  
سَبِيلًا ۝٣٥

36. Sigurisht, Ne i dhamë Musait Librin dhe i bëmë ndihmës vëllain e tij, Harunin.

وَلَقَدْ آتَيْنَا مُوسَىٰ الْكِتَابَ وَجَعَلْنَا مَعَهُ  
آخَاهُ هَارُونَ وَزِيرًا ۝٣٦

37. Dhe u thamë: Shkoni të dy te populli juaj, të cilët shenjat Tona i quajtën gënjeshtër. Pra, i shkatërruam tërësisht.

فَقُلْنَا أَذْهَبًا إِلَىٰ الْقَوْمِ الَّذِينَ كَذَّبُوا بِآيَاتِنَا  
فَدَمَّرْنَاهُمْ تَدْمِيرًا ۝٣٧

38. Edhe popullin e Nuhut, kur ata i quajtën gënjeshtarë të dërguarit, i fundosëm dhe i bëmë shenjë për njerëzit. Për keqberësit Ne kemi përgatitur një ndëshkim të dhimbshëm.

وَقَوْمَ نُوحٍ لَّمَّا كَذَّبُوا الرَّسَلَٰغَرَفُنَّهُمْ  
وَجَعَلْنَاهُمْ لِلنَّاسِ آيَةً ۗ وَاعْتَدْنَا لِلظَّالِمِينَ  
عَذَابًا أَلِيمًا ۝٣٨

39. (Po kështu) edhe Adin, edhe Themudin, edhe njerëzit e pusit<sup>5</sup> dhe shumë popuj të tjerë që ishin ndërmjet tyre.

وَ عَادًا وَ ثَمُودًا وَ أَصْحَابَ الرَّسِ  
وَ قُرُونًا بَيْنَ ذَلِكَ كَثِيرًا ۝٣٩

40. Për secilin kemi paraqitur shembuj dhe (në fund) secilin e kemi shkatërruar tërësisht.

وَ كَلَّا ضَرْبًا لَهُ الْأَمْثَالُ ۗ وَ كَلَّا تَتَّبَرْنَا  
تَتَّبِيرًا ۝٤٠

5. Se cilët ishin *njerëzit e pusit*, komentuesit kanë dhënë mendime të ndryshme. Por ky ajet tregon se ata kanë qenë pas popullit të Themudit, gjë që e mbështet edhe Endelusi në El-Bahrul-Muhit, duke sjellë pohimin e Hazret Ibn Abasit<sup>2a</sup> që thotë se ata ishin pjesë e themudëve. Kështu që, përderisa ishin pasardhës të adëve dhe të themudëve, duket se ata kanë jetuar në tokat arabe përpara se bijtë e Ismailit<sup>as</sup> të përhapeshin atje, dhe pasi bijtë e Ismailit u përhapën, janë zhvendosur në veri, në drejtim të Palestinës, siç tregojnë librat e historisë.

41. Dhe (këta kundërshtarë të tutë) kanë kaluar (shpesh) te fshati, të cilit i ra shiu i kobshëm. Atëherë, a nuk e kanë parë dot atë?! Përkundrazi, ata nuk shpresojnë ringjalljen.

وَلَقَدْ آتَوْا عَلَى الْقَرْيَةِ الَّتِي أَمْطَرْنَا  
مَطَرًا سَوِيًّا ۖ أَفَلَمْ يَكُونُوا يَرُوءَهَا بَلَّ  
كَانُوا لَا يَرْجُونَ نُشُورًا ﴿٤١﴾

42. Kur të të shohin, vetëm se tallen me ty: “A ky qenka ai që Allahu e ka caktuar të dërguar?!”

وَإِذَا رَأَوْكَ إِن يَتَّخِذُوكَ إِلَّا هُزُوعًا  
أَهَذَا الَّذِي بَعَثَ اللَّهُ رَسُولًا ﴿٤٢﴾

43. Mundej që ai të na devijonte nga idhujt tanë, po të mos kishim duruar!” Ata do të mësojnë së shpejti në kohën kur do të shohin ndëshkimin, se kush është më i devijuari nga rruga.

إِن كَادَ لَيُضِلَّنَا عَنْ الْهَيْتِ لَوْلَا أَن صَبَرْنَا  
عَلَيْهَا ۖ وَسَوْفَ يَعْلَمُونَ حِينَ يَرُونِ  
الْعَذَابَ مَنْ أَضَلُّ سَبِيلًا ﴿٤٣﴾

44. A e ke parë atë që dëshirën e vet e bën idhull? A mund të bëhesh garant edhe për të?!”

أَرَأَيْتَ مَنِ اتَّخَذَ إِلَهَهُ هَوَاهُ ۖ أَفَأَنْتَ  
تَكُونُ عَلَيْهِ وَكِيلًا ﴿٤٤﴾

45. A mendon se shumica prej tyre dëgjojnë ose kuptojnë?! Jo, ata janë vetëm si shtazë, madje akoma më të devijuar nga rruga.

أَمْ تَحْسَبُ أَنَّ أَكْثَرَهُمْ يَسْمَعُونَ أَوْ  
يَعْقِلُونَ ۖ إِن هُمْ إِلَّا كَالْأَنْعَامِ بَلَّ هُمْ  
أَضَلُّ سَبِيلًا ﴿٤٥﴾

46. A nuk e pe Zotin tënd si zgjati hijen? Po të donte, Ai do ta bënte atë të pandryshueshme. Më pas, Ne e bëmë diellin provë mbi të.

أَلَمْ تَرَ إِلَى رَبِّكَ كَيْفَ مَدَّ الظِّلَّ ۖ وَلَوْ  
شَاءَ لَجَعَلَهُ سَاكِنًا ۖ ثُمَّ جَعَلْنَا الشَّمْسَ  
عَلَيْهِ دَلِيلًا ﴿٤٦﴾

47. Më pas atë e tërheqim dalëngadalë drejt Nesh.

ثُمَّ قَبَضْنَاهُ إِلَيْنَا قَبْضًا يَسِيرًا ﴿٤٧﴾

48. Dhe është Ai që bëri për ju natën veshje, gjumin qetësi dhe e bëri ditën (mjet) përhapjeje (e zhvillimi).

وَهُوَ الَّذِي جَعَلَ لَكُمْ الَّيْلَ لِبَاسًا وَالنَّوْمَ  
سُبَاتًا ۖ وَجَعَلَ النَّهَارَ نُشُورًا ﴿٤٨﴾

49. Dhe është Ai që dërgoi erërat me lajmin e mirë për t'i paraprirë mëshirës së Tij. Dhe Ne zbritëm prej qiellit ujë të pastër.

وَهُوَ الَّذِي أَرْسَلَ الرِّيحَ بُشْرًا بَيْنَ يَدَيْ رَحْمَتِهِ ۗ وَأَنْزَلْنَا مِنَ السَّمَاءِ مَاءً طَهُورًا ﴿٤٩﴾

50. Që përmes tij t'i japim jetë një vendi të vdekur, dhe t'ua japim për të pirë atyre që kemi krijuar, bagëtime dhe njerëzve me shumicë.

لِنُحْيِيَ بِهِ بَلْدَةً مَيِّتًا وَنُسْقِيَهُ مِمَّا خَلَقْنَا أَنْعَامًا وَأَنَاسِيَّ كَثِيرًا ﴿٥٠﴾

51. Këtë e kemi shpjeguar në mënyrë të përsëritur mes tyre, që ata të mendohen. Por shumica e njerëzve vetëm se mohuan me mosmirënjohje.

وَلَقَدْ صَرَّفْنَا فِيهِمُ لِيَذَّكَّرُوا ۚ فَأَلَىٰ أَكْثَرِ النَّاسِ إِلَّا كُفُورًا ﴿٥١﴾

52. Dhe po të donim, patjetër do të ngrinim një alarmues në çdo fshat.

وَلَوْ شِئْنَا لَبَعَثْنَا فِي كُلِّ قَرْيَةٍ تَذِيرًا ﴿٥٢﴾

53. Andaj, mos ndiq mohuesit dhe përmes këtij (Kurani) bëj një xhihad madhor me ta.<sup>6</sup>

فَلَا تُطِيعِ الكُفْرَيْنِ وَجَاهِدْهُمْ بِهِ جِهَادًا كَبِيرًا ﴿٥٣﴾

6. Të përpiqesh e të angazhohesh në përhapjen e mesazhit të Islamit me anë të argumenteve që paraqet Kurani i Shenjtë, pra me anë të përpjekjeve intelektuale, e jo përmes armës e dhunës, është një xhihad shumë i madh. Është ky mesazhi i këtij ajeti. Sipas shumë dijetarëve, *xhihad* do të thotë të marrësh armën në dorë dhe të luftosh kundër atij që nuk e pranon fenë Islame, madje edhe kundër atij që quhet musliman por që e ndjek Islamin jo në mënyrën siç e kuptojnë ata, por në një mënyrë tjetër. Me keqardhje pohojmë se historia është dëshmitare se bazuar te këto *fetva* të të ashtuquajturve dijetarë, shumë shtete islamike kanë luftuar kundër njëra-tjetrës duke bërë vëllavrasje të madhe, të cilën e quajten “xhihad”. Por në të vërtetë, ky nuk është mësimi i Kuranit, dhe as nuk ka qenë kurrë. Është i dhimbshëm fakti që në shekujt e fundit, shumë sekte që e quajnë veten muslimane, madje disa edhe shtete islamike, praktikisht këtë kuptim ia kanë veshur fjalës xhihad, duke ndërmarrë luftëra gjakderdhëse, të cilat i bënë dhe vijnë t'i bëjnë për arsye politike, ekonomike apo edhe për ekspansionin e territoreve të veta. Si rezultat i kësaj veprimtarie barbare, fjala xhihad u kufizua dhe u përkufizua vetëm me konotacionin e luftës me armë. Këto luftëra mund të quheshin me çfarëdo emri tjetër, por si xhihad fetar kurrësi jo. Islami është feja e parë në botë, e cila në mënyrë kategorike pohoi: “*Nuk ka imponim në fe*” (2:257). Allahu i tërheq vëmendje çdo muslimani duke thënë: “*Dhe po të donte Zoti yt, do të besonin që të gjithë ata që banojnë në tokë. Ti, a do t'i imponosh vallë njerëzit, derisa të bëhen besimtarë?!*” (10:100)

Fjala *xhihad* rrjedh nga *xhehede* që do thotë: përpiqem palodhur për një kauzë (Lane). Nga Kurani dhe hadithet e Profetit<sup>savv</sup> mësojmë tri lloje të xhihadit: (1) xhihadi ose përpjekja

54. Është Ai që bashkoi dy dete: ky tejet i ëmbël dhe ky tjetri fort i njelmët. Dhe mes tyre vuri (përkohësisht) një pengesë dhe ndarje të pakapërcyeshme.<sup>7</sup>

وَهُوَ الَّذِي مَرَجَ الْبَحْرَيْنِ هَذَا عَذْبٌ  
فُرَاتٌ وَهَذَا مِلْحٌ أُجَاجٌ ۖ وَجَعَلَ بَيْنَهُمَا  
بَرْزَخًا وَحِجْرًا مَّحْجُورًا ۝٥٤

kundër djallit dhe vetvetes, për të gjetur Zotin e Madhërishëm (29:70); (2) xhihadi ose përpjekja me anë të argumenteve të Kuranit për të përhapur Islamit (25:53) dhe (3) xhihadi ose përpjekja për t'u mbrojtur nga ata që ju persekutojnë në mënyrë kolektive, ju dëbojnë nga vendi juaj dhe ju sulmojnë për shkak të besimit (22:39-42). Tek po kthehej nga një betejë, Profeti<sup>savs</sup> këtë të fundit e quajti si xhihadin më të vogël, kurse xhihadin kundër vetvetes si më të madhin. (Alauddin El-Mutteki, "Kenzul Umal", Kitabul-xhihad fil-xhihadil-ekber minel-a'mal, vëll. 4, hadithi 11260, botuar nga "Mekteba Et-turathul Islamiji", Haleb).

Sipas Kuranit dhe haditheve të Profetit<sup>savs</sup>, është e qartë se dy të parat njihen si xhihadet më të mëdha, kurse ai i fundit si xhihadi më i vogël. Veç kësaj, dy të parat janë të obliguara për çdo musliman, në çdo kohë e në çdo vend, ndërsa ai i fundit është krejtësisht i kufizuar nga rrethanat specifike dhe është i obliguar vetëm kur ka nevojë. Nëse shohim jetën e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, nevoja për xhihadin me armë lindi pas sflitjesh të skëtërrshme shumëveçare që armiqtë ia bënë muslimanëve: së pari muslimanëve ua hoqën të drejtën për të adhuruar Allahun, Zotin e Vetëm; për një kohë të gjatë i përndoqën dhe shumë të tjerë i vranë, pastaj, muslimanët mërguan në një vend tjetër për të gjetur paqe, por kundërshtarët i ndoqën edhe atje dhe i sulmuan, të gjithë këtë e bënë vetëm për shkak të besimit. Në këto kushte, Zoti u dha muslimanëve të drejtën e vetëmbrojtjes, pra të xhihadit me armë.

Themeluesi i Xhematit Musliman Ahmedia, *Hazret Mirza Ghulam Ahmed*<sup>as</sup>, në fund të shekullit 19-të, u bëri thirrje muslimanëve të hiqnin dorë nga *xhihadi me armë*, pasi nuk ishte më koha për një xhihad të tillë sepse muslimanët tanimë gëzonin lirinë e besimit thuajse në të gjithë botën. Ai theksoi se në kohën e sotme kur të gjitha fetë kanë dalë në arenën e argumenteve, edhe teknologjia ka avancuar deri në atë masë që komunikimi mes njerëzve është bërë shumë më i lehtë sesa në kohën e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, ne duhet të luftojmë përmes Kuranit të Shenjtë, duke u thelluar në dijet e tij dhe duke përhapur argumentet e tij. Kjo pikërisht do të ishte edhe koha e ardhjes së Imam Mehdiut, sepse pikërisht në këtë kohë do të provohej epërsia e Islamit mbi fetë e tjera, siç është e parashikuar në 61:10. Prandaj, edhe Profeti Muhammed<sup>savs</sup> tha se Mesihu i Premtuar "do ta ndërpresë luftën (fetare)" (Askalani, Sherh Buhari, 3448) dhe se në kohën e tij "lufta (fetare) do të dorëzojë armët e saj" (Musned Ahmed, 9323). Në vitin 1902, duke iu drejtuar muslimanëve, *Hazret Mirza Ghulam Ahmedi*, Mesih i Premtuar<sup>as</sup> gjithashtu u tha – "Çdokush që do të shkojë për luftë edhe pas këtij urdhri; le ta dijë se do të turpërohet rëndë nga mohuesit!" ("Ruhani Khazain" vëll. 17, "Tohfa-e-Gularviye", f. 78). Historia njëqindveçare është dëshmitare e faktit se sa shumë humbje "xhihadistët" i shkaktuan Islamit dhe muslimanëve. Lexoni edhe 22:42.

7. Këtu bëhet fjalë për Oqeanin Paqësor dhe Oqeanin Atlantik. I pari është relativisht i kripur, kurse i dyti tejet i njelmët, dhe midis dy oqeanëve ka një pengesë, për të cilën në një ajet tjetër thuhet se ajo do të largohet dhe kjo do t'i bashkojë të dyja oqeanet.

55. Është Ai që krijoi njeriun prej ujit dhe bëri për të (familje) të trungut atëror dhe të trungut të bashkëshortes. Zoti yt është i Plotfuqishëm.

وَهُوَ الَّذِي خَلَقَ مِنَ الْمَاءِ بَشَرًا فَجَعَلَهُ  
نَسَبًا وَصِهْرًا ۗ وَكَانَ رَبُّكَ قَدِيرًا ﴿٥٥﴾

56. Duke lënë Allahun ata adhurojnë diçka që nuk u sjell dot as dobi e as dëm. Mohuesi bëhet ndihmës kundër Zotit të vet.

وَيَعْبُدُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ مَا لَا يَنْفَعُهُمْ  
وَلَا يَضُرُّهُمْ ۗ وَكَانَ الْكَافِرُ عَلَىٰ رَبِّهِ  
ظَهِيرًا ﴿٥٦﴾

57. Ne nuk të dërguam ty veçse si sihariqdhënës dhe alarmues.

وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا مُبَشِّرًا وَنَذِيرًا ﴿٥٧﴾

58. Thuaj: Nuk ju kërkoj ndonjë shpërblim për këtë, por vetëm se kushdo që dëshiron, le të marrë rrugë drejt Zotit të tij.

قُلْ مَا أَسْأَلُكُمْ عَلَيْهِ مِنْ أَجْرٍ إِلَّا مَنْ  
شَاءَ أَنْ يَتَّخِذَ إِلَىٰ رَبِّهِ سَبِيلًا ﴿٥٨﴾

59. Mbështetu te i Gjalli që nuk vdes, dhe përkujtoje duke lavdëruar Atë. Ai është i mjaftueshëm për të qenë i Gjithinformuar për mëkatet e robërve të Tij.

وَتَوَكَّلْ عَلَىٰ الْحَيِّ الَّذِي لَا يَمُوتُ  
وَسَبِّحْ بِحَمْدِهِ ۗ وَكْفَىٰ بِهِ بُدْنُوبٍ عِبَادِهِ  
حَيْرًا ﴿٥٩﴾

60. Ai që krijoi qiejt, tokën dhe atë që është mes tyre, në gjashtë ditë,<sup>8</sup> më pas u vendos në Arsh. (Ai) është

الَّذِي خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ وَمَا  
بَيْنَهُمَا فِي سِتَّةِ أَيَّامٍ ثُمَّ اسْتَوَىٰ عَلَىٰ

8. Disa njerëz ngrenë pyetjen se pse Zotit iu deshën *gjashtë ditë* për ta krijuar gjithësinë dhe se kjo, sipas tyre, nënkupton dobësinë e Tij. Përgjigjja është që fuqia jo domosdo quhet vetëm kur një punë e caktuar kryhet përnjëherë, pa arsye. Jo! I përsosur në fuqi quhet ai që e realizon punën përmes saj mu sipas dëshirës së tij, qoftë menjëherë, qoftë gradualisht. Marrim shembullin e të ecurit. Nuk do të quanim të përsosur në të ecurit atë që di vetëm të eci shpejt dhe që nuk ecën dot ngadalë, por atë që di të eci në të dyja mënyrat sipas vullnetit të tij. Edhe punët e Zotit janë sipas vullnetit të Tij. Mjafton të shohim ligjet e natyrës. Disa caktime Zoti i vë në fuqi përnjëherë, e disa të tjera gradualisht. Po, vihet re që atributet e Tij të ashpërsisë ose të ndëshkimit, kur aktivizohen, vihen në lëvizje me shpejtësi, kurse atributet e butësisë së Tij, zakonisht shfaqen ngadalshëm. Për shembull, Zoti ka caktuar që njeriu të kalojë një periudhë nëntë muaj në barkun e nënës për t'u përsosur, për t'u bërë njeri dhe për të lindur, kurse vdekja e tij mund të ndodhë qoftë në një çast të vetëm.

i Gjithëmëshirshmi, andaj pyet dikë që është i informuar për Të.<sup>9</sup>

61. Kur atyre u thuhet: “Bëni sexhde për të Gjithëmëshirshmin!”, ata thonë: “Çfarë është i Gjithëmëshirshmi? A të bëjmë sexhde për Atë që na urdhëruake ti?!” Dhe kjo ua shtoi mohimin edhe më shumë.

Sexhdeja VIII

62. Vetëm Ai ka bekime që bëri yjësi në qiell dhe në të vuri një llambë të shndritshme (pra, diellin), dhe një hënë të ndriçuar.

63. Dhe është Ai që bëri natën dhe ditën si pasuese (të njëra-tjetrës), për atë që dëshiron të mendohet ose që dëshiron të falënderojë.

64. Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin në tokë me përlësi, dhe kur atyre u drejtohen injorantët, ata u thonë: “Selam!”

65. Dhe janë ata që kalojnë netët për Zotin e tyre duke bërë sexhde dhe duke qëndruar në këmbë.

66. Dhe ata që thonë: “O Zoti ynë! Largo prej nesh ndëshkimin e xhehenemit! Njëmend, ndëshkimi i tij është ngjites!

67. Pa dyshim, (xhehenemi) është i keq edhe si qëndrim i përkohshëm, edhe si vend i përhershëm.

الْعَرْشِ ۙ الرَّحْمٰنُ فَسَلِّ بِهٖ حَيْثَ ۙ ۝۹

وَإِذَا قِيلَ لَهُمُ اسْجُدُوا لِلرَّحْمٰنِ قَالُوا وَمَا الرَّحْمٰنُ ۙ أَنَسْجُدُ لِمَا تَأْمُرُنَا وَزَادَهُمْ نُفُورًا ۝۱۰

تَبٰرَكَ الَّذِي جَعَلَ فِي السَّمَآءِ بُرُوجًا وَجَعَلَ فِيهَا سِرَاجًا وَقَمَرًا مُنِيرًا ۝۱۱

وَهُوَ الَّذِي جَعَلَ اللَّيْلَ وَالنَّهَارَ خِلْفَةً لِّمَنۢ أَرَادَ أَنۢ يَّذْكَرَ ۙ أَوْ أَرَادَ شُكُورًا ۝۱۲

وَعِبَادُ الرَّحْمٰنِ الَّذِينَ يَمْشُونَ عَلَى الْأَرْضِ هَوْنًا وَإِذَا خَاطَبَهُمُ الْجَاهِلُونَ قَالُوا سَلَامًا ۝۱۳

وَالَّذِينَ يَبِيتُونَ لِرَبِّهِمْ سُجَّدًا وَقِيَامًا ۝۱۴

وَالَّذِينَ يَقُولُونَ رَبَّنَا اصْرِفْ عَنَّا عَذَابَ جَهَنَّمَ ۙ إِنَّ عَذَابَهَا كَانَ غَرَامًا ۝۱۵

إِنَّهَا سَاءَتْ مُسْتَقَرًّا وَمُقَامًا ۝۱۶

9. Fjalët “i informuar për Të” nënkuptojnë Profetin Muhammed<sup>saws</sup>, të cilit Allahu i Madhërishtëm përmes shpalljes i dha dijen e attributeve të Tij.



68. Dhe ata të cilët kur shpenzojnë, as nuk e teprojnë dhe as nuk bëhen koprracë, por mbajnë një qëndrim ndërmjet këtyre (të dyjave).

وَالَّذِينَ إِذَا أَنْفَقُوا لَمْ يُسْرِفُوا وَلَمْ يَقْتُرُوا وَكَانَ بَيْنَ ذَلِكَ قَوَامًا ﴿٦٨﴾

69. Dhe ata që nuk lusin asnjë të adhurueshëm tjetër bashkë me Allahun, nuk vrasin padrejtësisht asnjë shpirt që Allahu e ka ndaluar dhe nuk bëjnë kurvëri. Dhe kushdo që bën një gjë të tillë, do ta gjejë (ndëshkimin e) mëkatit.

وَالَّذِينَ لَا يَدْعُونَ مَعَ اللَّهِ إِلَهًا آخَرَ وَلَا يَقْتُلُونَ النَّفْسَ الَّتِي حَرَّمَ اللَّهُ إِلَّا بِالْحَقِّ وَلَا يَزْنُونَ ۗ وَمَنْ يَفْعَلْ ذَلِكَ يَلْقَ أَثَامًا ﴿٦٩﴾

70. Ditën e Kiametit atij do t'i shtohet ndëshkimi, dhe ai do të mbetet në të i poshtëruar për një kohë të gjatë.

يُضْعَفُ لَهُ الْعَذَابُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ وَيَجْلُدُ فِيهِ مُهَانًا ﴿٧٠﴾

71. Përveç atij që u pendua, besoi dhe bëri vepër të mirë. Të tillëve Allahu do t'ua ndryshojë mëkatet në mirësi. Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

إِلَّا مَنْ تَابَ وَآمَنَ وَعَمِلَ عَمَلًا صَالِحًا فَأُولَٰئِكَ يُبَدِّلُ اللَّهُ سَيِّئَاتِهِمْ حَسَنَاتٍ ۗ وَكَانَ اللَّهُ غَفُورًا رَحِيمًا ﴿٧١﴾

72. Dhe pikërisht ai që u pendua dhe bëri të mira, kthehet i penduar tek Allahu.

وَمَنْ تَابَ وَعَمِلَ صَالِحًا فَإِنَّهُ يَتُوبُ إِلَى اللَّهِ مَتَابًا ﴿٧٢﴾

73. Dhe ata që nuk japin dëshmi të rreme, dhe kur kalojnë pranë kotësive, kalojnë me dinjitet.

وَالَّذِينَ لَا يَشْهَدُونَ الزُّورَ ۗ وَإِذَا مَرُّوا بِاللَّغْوِ مَرُّوا كِرَامًا ﴿٧٣﴾

74. Dhe ata që kur (dikush) ua kujton ajetet e Zotit të tyre, nuk u qasen si të shurdhër e të verbër.

وَالَّذِينَ إِذَا ذُكِّرُوا بِآيَاتِ رَبِّهِمْ لَمْ يَخِرُّوا عَلَيْهَا صُمًّا وَعُمْيَانًا ﴿٧٤﴾

75. Dhe ata që thonë: “O Zoti ynë! Na dhuro prehjen e syve nga bashkëshortët dhe fëmijët tanë dhe na bëj udhëheqës të të devotshmëve!”

وَالَّذِينَ يَقُولُونَ رَبَّنَا هَبْ لَنَا مِنْ أَرْوَاجِنَا وَذُرِّيَّاتِنَا قُرَّةَ أَعْيُنٍ وَاجْعَلْنَا لِلْمُتَّقِينَ إِمَامًا ﴿٧٥﴾

76. Pikërisht këta do të shpërblehen me pallate (në lartësi) për atë që duruan, ku atyre do t'u bëhet mirësearchje dhe do t'u jepet selam.

أُولَئِكَ يُجْزَوْنَ الْغُرْفَةَ بِمَا صَبَرُوا  
وَيُلَقَّوْنَ فِيهَا تَحِيَّةً وَسَلَامًا ﴿٧٦﴾

77. Në ato (xhenete) do të jetojnë përgjithmonë. Sa i mirë qenka ai edhe si qëndrim i përkohshëm, edhe si vend i përhershëm!

خَالِدِينَ فِيهَا حَسَنَتْ مُسْتَقَرًّا وَمُقَامًا ﴿٧٧﴾

78. Thuaj: Nuk do t'ju përfillë Zoti im, po të mos jetë lutja juaj. Dhe ju e kenë quajtur gënjeshtër, andaj do t'ju zërë ndëshkimi së shpejti.

قُلْ مَا يَعْبُؤُا بِكُمْ رَبِّي لَوْلَا دُعَاؤُكُمْ  
فَقَدْ كَذَّبْتُمْ فَسَوْفَ يَكُونُ لِزَامًا ﴿٧٨﴾

## Surja 26 - Esh-Shuara

Surja Esh-Shuara është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka dyqind e njëzet e tetë ajete.

Edhe një herë surja fillon me shkurtesat në të cilat, shkronja *sin* (s) vjen për herë të parë. Ajo mund të ketë kuptime të ndryshme, megjithatë, disa njerëz që kanë dije, i interpretojnë këto shkronja kështu: *Ta* do të thotë *Tajjib* (*i Pastër, i Mirë*); *Sin* do të thotë *Semi* (*Gjithëdëgjues*); dhe *Mim* përfaqëson atributin *‘Alim* (*i Gjithëdijshëm*).

Në ajetin e fundit të sures paraardhëse u tha se kur njeriu mohon lutjen dhe e shképut lidhjen me Zotin e Madhërishëm, atij i ngjiten lloj-lloj sëmundjesh shpirtërore. Si shembuj të këtij fenomeni, kjo sure përmend popujt me të cilët kështu ishte sjellë Zoti i Madhërishëm për shkak se edhe ata e mohuan lutjen. Dhe çdo herë përmendjen e një populli mohues e mbyll me atributet e Zotit “*i Plotfuqishëm dhe Mëshirëbërës*” (*El-‘Azizurr-Rrahim*). Përsëritja e atributit “Mëshirëbërës” tregon se, pavarësisht se ata vazhdimisht refuzojnë të Vërtetën, Zoti i Madhërishëm vazhdimisht i mëshiron dhe u jep një mundësi të re, vetëm në saje të mëshirës së Tij.

Atributi tjetër i përsëritur është El-‘Aziz, që do të thotë edhe Mbizotërues a i Plotfuqishëm, edhe i Nderuar. Përmendja e tij në mënyrë të përsëritur tregon se armiqtë e Allahut bënë çdo përpjekje për të poshtëruar Profetët, por Zoti i tyre (pra, i Profetëve) që është El-‘Aziz (i Nderuari), u siguroi Profetëve nder të përhershëm.

Pas kësaj, Zoti e porositi Profetin Muhammed<sup>savs</sup> që ai të paralajmëronte të afërmit e tij për fundin e keq të ligësive të tyre, dhe të ulte krahun e mëshirës për të afërmit e tij shpirtërorë. Nëse mohuesit insistojnë mohimin, i tha Zoti, thuaju: Distancohem nga mohimi juaj dhe i mbështetem vetëm Allahut që është Mbizotërues, i Urtë, Mëshirëbërës, që dëgjon shumë lutjen dhe është i Gjithëdijshëm.

Pas kësaj vjen një argument që provon në mënyrë të prerë se Profetët kurrsesi nuk mund të frymëzohen nga djajtë, pasi ata nuk janë as shpifës e as të ligj, përkundrazi, sinqeritetin dhe pastërtinë e tyre e dëshmojnë të gjithë njerëzit që i rrethojnë.

Njëra prej veçorive të Fjalës që iu zbrit Profetit Muhammed<sup>savs</sup> është që ajo ka një nivel shumë të lartë letrar dhe poetik. Duke e parë këtë veti të Kuranit të Shenjtë, shumë poetë arabë që pranuan Islamin hoqën dorë nga poezia. Por nga ky fakt nuk mund të nxjerrësh përfundimin se Profeti Muhammed<sup>savs</sup> ishte një poet. Kjo për arsye se poetët në përgjithësi enden në fantazinë e tyre, kurse Kurani Famëlartë pavarësisht nga standardi i lartë letrar i tij, nuk merret me fantazinë dhe trillimin.

Pas kësaj, Kurani i Shenjtë shfaqëson edhe poetët muslimanë, të cilët besojnë, bëjnë vepra të mira, përkujtojnë shumë Allahun e Madhërishëm dhe hakmerren kur u bëhet padrejtësi. Këtu u referohet atyre poetëve muslimanë, të cilët u hakmorën me anë të poezisë së tyre për Profetin Muhammed<sup>savs</sup>, kur Profetin e sulmonin poetët gjuhënepërkë të mohuesve.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. *Ta.Sin.Mim.* (i Pastër, Gjithëdëgjues, i Gjithëdijshtëm.)<sup>1</sup>

طَسْمٌ ①

3. Këto janë ajete të Librit të qartë.

تِلْكَ آيَاتُ الْكِتَابِ الْمُبِينِ ①

4. A do të vrasësh veten se pse ata nuk po bëhen besimtarë?!<sup>2</sup>

لَعَلَّكَ بَاخِعٌ نَفْسِكَ أَلَّا يَكُونُوا

مُؤْمِنِينَ ①

5. Nëse duam, do të zbresim mbi ta ndonjë shenjë prej qiellit, para së cilës atyre do t'u ulen kokat.

إِنْ نَشَأْ نُزِّلْ عَلَيْهِمْ مِنَ السَّمَاءِ آيَةً

فَضَلَّتْ أَعْنَاقَهُمْ لَهَا خِضَعِينَ ①

6. Sa herë që u vjen ndonjë këshillë e re prej të Gjithëmëshirshmit, ata vetëm se e shpërfillin atë.

وَمَا يَأْتِيهِمْ مِنْ ذِكْرِ مِنَ الرَّحْمَنِ مُحَدَّثٍ

إِلَّا كَانُوا عَنْهُ مُعْرِضِينَ ①

7. Pra, ata quajten gënjeshtër (çdo shenjë të re), andaj, do t'u vijjnë patjetër lajmet, të cilat ata i përqeshnin.

فَقَدْ كَذَّبُوا فَسَيَأْتِيهِمْ أَتْبَؤُا مَا كَانُوا بِهِ

يَسْتَهْزِئُونَ ①

8. A nuk shohin te toka se sa shumë çifte të këndshme (bimësh) kemi nxjerrë në të?!

أَوَلَمْ يَرَوْا إِلَى الْأَرْضِ كَمَا أُتْبِتْنَا فِيهَا

مِنْ كُلِّ رَوْحٍ كَرِيمٍ ①

1. D.m.th. kjo sure flet për pastërtinë e zemrës, për pranimin e lutjes dhe për mjetet me të cilat mund të arrijmë dëlirësinë.

2. I Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> donte me gjithë shpirt që njerëzit të mos mbeteshin të privuar nga besimi dhe që Islami të përhapej në vend. Brenga e tij ishte shumë e madhe, të cilën ky ajet e përshkruan më së miri. Ishte pikërisht ky përkushtim i tij kaq i lartë, që Allahu nuk i dha vdekjen pa i dhënë lajmin e mirë të fitores që përmendet në suren 110, një lajm të tillë që Profetët e tjerë nuk e morën gjatë jetës së tyre.

9. Sigurisht, në të ka shenjë, por shumica prej tyre nuk besojnë.

إِنَّ فِي ذَٰلِكَ لَآيَةً ۖ وَمَا كَانَ أَكْثَرُهُمْ  
مُؤْمِنِينَ ⑩

10. Dhe pa dyshim, pikërisht Zoti yt është Mbizotëruesi, Mëshirëbërësi.

وَإِنَّ رَبَّكَ لَهُوَ الْعَزِيزُ الرَّحِيمُ ⑪

11. Kur Zoti yt thirri Musain: “Shko te populli keqberës,

وَإِذْ نَادَى رَبُّكَ مُوسَىٰ أَنْ ائْتِ الْقَوْمَ  
الظَّالِمِينَ ⑫

12. te populli i Faraonit (dhe pyeti), a nuk druhen?”

قَوْمَ فِرْعَوْنَ ۗ أَلَا يَتَّقُونَ ⑬

13. Ai tha: “O Zoti im! Njëmend, unë kam frikë se do të më quajnë gënjeshtar.

قَالَ رَبِّ إِنِّي أَخَافُ أَنْ يُكَذِّبُونِ ⑭

14. Më shtrëngohet gjoksi dhe nuk më flet as gjuha, prandaj, dërgoji (zbulesën) Harunit

وَيَضِيقُ صَدْرِي وَلَا يَنْطَلِقُ لِسَانِي  
فَأَرْسَلْ إِلَىٰ هَارُونَ ⑮

15. Veç kësaj, atyre u kam dhe një faj, ndaj, frikësohem se do të më vrasin.”

وَلَهُمْ عَلَيَّ ذَنْبٌ فَأَخَافُ أَنْ يَقْتُلُونِ ⑯

16. (Zoti) tha: Kurrsesi. Ju të dy shkoni me shenjat Tona! Sigurisht, Ne për ju jemi shumë Dëgjues.

قَالَ كَلَّا ۗ فَاذْهَبَا بِآيَاتِنَا إِنَّا مَعَكُمْ  
مُسْتَمِعُونَ ⑰

17. Pra, shkoni te Faraoni dhe thuajini: “Ne jemi të dërguar të Zotit të botëve,

فَأْتِيَا فِرْعَوْنَ فَقُولَا إِنَّا رَسُولُ رَبِّ  
الْعَالَمِينَ ⑱

18. (dhe) se lësho me ne bijtë e Izraelit.”

أَنْ أَرْسِلْ مَعَنَا بَنِي إِسْرَائِيلَ ⑲

19. (Faraoni) tha: “A nuk të kemi rritur pranë nesh që në vegjëli dhe ti kalove shumë vite të jetës sate mes nesh?!

قَالَ أَلَمْ نُرَبِّكَ فِينَا وَلِيدًا وَلَبِثْتَ فِينَا  
مِنْ عُمْرِكَ سِنِينَ ⑳

20. Bëre dhe një veprim që bëre (vetëm) ti. Je prej mos-mirënjohësve.”

وَفَعَلْتَ فَعَلْتَكِ الْآتِي فَعَلْتَ وَأَنْتَ مِنَ الْكٰفِرِيْنَ ۝

21. (Musai) tha: “E kam bërë atë atëherë kur isha prej të devijuarve.

قَالَ فَعَلْتَهَا اِذَا وَاَنَا مِنَ الصّٰلِحِيْنَ ۝

22. Pastaj u largova kur pata frikë prej jush, atëherë Zoti im më dhuroi urtësinë dhe më bëri prej të Dërguarve.

فَفَرَرْتُ مِنْكُمْ لَمَّا خِفْتُمْكُمْ فَوَهَبَ لِي رَبِّيْ حُكْمًا وَجَعَلَنِي مِنَ الْمُرْسَلِيْنَ ۝

23. (A) kjo qenka mirësia që ma bëre, që i robërove bijtë e Izraelit?!”

وَتِلْكَ نِعْمَةٌ تَمُنُّهَا عَلَيَّ اَنْ عَبَّدتَّ بَنِيْ اِسْرٰءِيْلَ ۝

24. Faraoni tha: “E çfarë qenka Zoti i botëve?”

قَالَ فِرْعَوْنُ وَمَا رَبُّ الْعٰلَمِيْنَ ۝

25. (Musai) tha: “Zoti i qiejve, i tokës dhe i asaj që gjendet mes të dyjave, nëse doni të besoni.”

قَالَ رَبُّ السَّمٰوٰتِ وَالْاَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا ۝ اِنْ كُنْتُمْ مُّوَقِنِيْنَ ۝

26. (Faraoni) u tha atyre që e rrethonin: “A po dëgjoni?!”

قَالَ لِمَنْ حَوْلَهٗ اَلَا تَسْمَعُوْنَ ۝

27. (Musai) tha: “Ai është Zoti juaj dhe Zoti i etërve tuaj të parë.”

قَالَ رَبُّكُمْ وَرَبُّ اٰبَائِكُمْ الْاَوَّلِيْنَ ۝

28. (Faraoni) tha: “Ky i Dërguar që ju është dërguar juve, me siguri qenka i çmendur!”<sup>3</sup>

قَالَ اِنَّ رَسُوْلَكُمْ الَّذِيْ اُرْسِلَ اِلَيْكُمْ لَمَجْنُوْنٌ ۝

29. (Musai) tha: “Ai është Zoti i Lindjes dhe i Perëndimit dhe i asaj që gjendet mes të dyjave, nëse doni të kuptoni.”

قَالَ رَبُّ الْمَشْرِقِ وَالْمَغْرِبِ وَمَا بَيْنَهُمَا ۝ اِنْ كُنْتُمْ تَعْقِلُوْنَ ۝

3. Faraoni e quan “të çmendur” Hazret Musain<sup>as</sup> për arsye se sipas tij, Musai nuk po frikësohej ta thoshte atë, të cilën ai e kishte kundërshtuar.

30. (Faraoni) tha: “Nëse zgjedh ndonjë Zot tjetër përveç meje, unë patjetër do të të burgos.”

قَالَ لِيِنِ اتَّخَذْتَ إِلَهًا غَيْرِي لَأَجْعَلَنَّكَ  
مِنَ الْمَسْجُونِينَ ﴿٣٠﴾

31. Ai tha: “Edhe nëse unë të të sjell diçka shumë të qartë?”

قَالَ أَوْ لَوْ جِئْتُكَ بِشَيْءٍ مُّبِينٍ ﴿٣١﴾

32. Ai tha: “Sille pra, nëse thua të vërtetën!”

قَالَ فَأْتِ بِهِ إِنْ كُنْتَ مِنَ الصَّادِقِينَ ﴿٣٢﴾

33. Atëherë (Musai) hodhi shkopin e vet, i cili sakaq u bë gjarpër i dukshëm.

فَأَنفَىٰ عَصَاهُ فَإِذَا هِيَ ثُعْبَانٌ مُّبِينٌ ﴿٣٣﴾

34. Më pas, nxori dorën e tij, dhe ajo papritmas u bë e bardhë për shikuesit.

فَنَزَعَ يَدَهُ فَإِذَا هِيَ بَيْضَاءُ لِلظَّاهِرِينَ ﴿٣٤﴾

35. (Faraoni) i tha parisë që e rrethonin: “Me siguri ky qenka një mjeshtër magjistar!”

قَالَ لِلْمَلَآئِكَةِ إِنَّ هَذَا السَّحِرُ عَلِيمٌ ﴿٣٥﴾

36. Dëshiron t’ju dëbojë nga toka juaj me magjinë e tij. Atëherë, çfarë më këshilloni?”

يُرِيدُ أَنْ يُخْرِجَكُمْ مِّنْ أَرْضِكُمْ  
بِسِحْرِهِ ۖ فَمَاذَا تَأْمُرُونَ ﴿٣٦﴾

37. Ata thanë: “Jepu kohë këtij dhe vëllait të tij dhe dërgo grumbulluesit nëpër qytete.

قَالُوا أَرْجِهْ وَأَخَاهُ وَأَبْعَثْ فِي الْمَدَائِنِ  
حُشْرِينَ ﴿٣٧﴾

38. Ata do të të sjellin çdo mjeshtër magjistar të fortë.”

يَأْتُوكَ بِكُلِّ سِحَّارٍ عَلِيمٍ ﴿٣٨﴾

39. Atëherë u mblodhën magjistarët në kohën (dhe) ditën e caktuar.

فَجَمَعَ السَّحَرَةَ لِمِيقَاتِ يَوْمٍ مَّعْلُومٍ ﴿٣٩﴾

40. U thanë edhe njerëzve: “A do të mblidheni ju?”

وَقِيلَ لِلنَّاسِ هَلْ أَنْتُمْ مُّجْتَمِعُونَ ﴿٤٠﴾

41. Që t’i ndjekim magjistarët, nëse do të triumfojnë.”

لَعَلَّنَا نَتَّبِعُ السَّحَرَةَ إِنْ كَانُوا هُمُ  
الْغَالِبِينَ ﴿٤١﴾

42. Magjistarët kur erdhën, i thanë Faraonit: “A do të kemi ndonjë shpërblim, nëse do të fitojmë ne?”

فَلَمَّا جَاءَ السَّحَرَةُ قَالُوا لِفِرْعَوْنَ أَإِنَّا  
لَنَا لَأَجْرًا إِن كُنَّا نَحْنُ الْغَالِبِينَ ﴿٤٢﴾

43. Ai tha: “Po, dhe në këtë rast, patjetër do të bëheni (miq) të afërm.”

قَالَ نَعَمْ وَإِنَّكُمْ إِذَا لَمِنَ الْمُتَقَرَّبِينَ ﴿٤٣﴾

44. Musai u tha (magjistarëve): “Hidhni atë që keni për të hedhur.”

قَالَ لَهُمْ مُوسَى أَلْقُوا مَا أَنْتُمْ مُلْقُونَ ﴿٤٤﴾

45. Atëherë ata hodhën (në tokë) litarët dhe shkopinj të tyre dhe thanë: “Për nderin e Faraonit! Do të jemi ne fitues!”

فَأَلْقُوا جِبَالَهُمْ وَعِصِيَّهُمْ وَقَالُوا بِعِزَّةِ  
فِرْعَوْنَ إِنَّا لَنَحْنُ الْغَالِبُونَ ﴿٤٥﴾

46. Dhe Musai hodhi shkopin e tij, dhe papritmas, ai filloi të gllabëronte gjithçka që ata kishin sajuar.

فَأَلْفَى مُوسَى عَصَاهُ فَإِذَا هِيَ تَلْقَفُ مَا  
يَأْفِكُونَ ﴿٤٦﴾

47. Atëherë magjistarët ranë në sexhde.

فَأَلْقَى السَّحَرَةُ سُجُودًا ﴿٤٧﴾

48. Thanë: “Besuam në Zotin e botëve,

قَالُوا آمَنَّا بِرَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿٤٨﴾

49. (në) Zotin e Musait dhe të Harunit.”

رَبِّ مُوسَى وَهَارُونَ ﴿٤٩﴾

50. (Faraoni) tha: “A besuat në të pa ju dhënë leje unë?! Me siguri ky është i madhi juaj që ju ka mësuar magjinë. Së shpejti do të mësoni (ndëshkimin)! Unë përnejmënd do t’ju pres duart dhe këmbët të anëve të ndryshme dhe do t’ju kryqëzoj ju të gjithë.”

قَالَ أَمْتُمْ لَهُ قَبْلَ أَنْ أَدْنِ لَكُمْ ۗ إِنَّهُ  
لَكَبِيرٌ كُمْ الَّذِي عَلَّمَكُمُ السِّحْرَ ۗ  
فَلَسَوْفَ تَعْلَمُونَ ۗ لَا قِطْعَانَ أَيْدِيكُمْ  
وَأَرْجُلِكُمْ مِنْ خِلَافٍ ۗ وَلَا وَصَلَتِكُمْ  
أَجْمَعِينَ ﴿٥٠﴾

51. Ata thanë: “Nuk kemi frikë. Ne, sigurisht, te Zoti ynë do të kthehemi.

قَالُوا لَا ضَيْرَ ۗ إِنَّا إِلَىٰ رَبِّنَا مُنْقَلِبُونَ ﴿٥١﴾



52. Ne shpresojmë që Zoti ynë të na i fal gabimet, pasi jemi bërë besimtarët e parë.”

إِنَّا نَطْمَعُ أَنْ يَغْفِرَ لَنَا رَبُّنَا خَطِيئَاتِنَا أَنْ كُنَّا  
أَوَّلَ الْمُؤْمِنِينَ ﴿٢٦﴾

53. Dhe i shpallëm Musait: Nisu gjatë natës me robërit e Mi. Sigurisht, do të ndiqeni.

وَأَوْحَيْنَا إِلَىٰ مُوسَىٰ أَنْ أَسْرِ بِعِبَادِي  
إِنَّكُمْ مُتَّبِعُونَ ﴿٢٧﴾

54. Dhe Faraoni dërgoi grumbulluesit nëpër qytete,

فَأَرْسَلَ فِرْعَوْنُ فِي الْمَدَائِنِ حَاشِرِينَ ﴿٢٨﴾

55. (me njoftimin se) “Këta janë një pakicë e vogël,

إِنَّ هَؤُلَاءِ لَشِرْذِمَةٌ قَلِيلُونَ ﴿٢٩﴾

56. dhe prapëseprapë na zemërojnë.

وَإِنَّهُمْ لَنَا لَغَائِظُونَ ﴿٣٠﴾

57. Dhe ne të gjithë patjetër do të jemi vigilentë.”

وَإِنَّا لَجَمِيعٌ حَازِرُونَ ﴿٣١﴾

58. Atëherë Ne i nxorëm ata prej kopshteve dhe burimeve,

فَأَخْرَجْنَاهُمْ مِنْ جَنَّاتٍ وَعَيْونٍ ﴿٣٢﴾

59. edhe (prej) thesareve dhe pozitave të nderuara.

وَكُنُوزٍ وَمَقَامٍ كَرِيمٍ ﴿٣٣﴾

60. Kështu (ndodhi). Dhe Ne i bëmë bijtë e Izraelit që ta trashëgojnë atë (tokë).

كَذَلِكَ ۖ وَأَوْرَثْنَاهَا بِنِيٍّ إِسْرَائِيلَ ﴿٣٤﴾

61. Ata i ndoqën ndaj të gdhirë.

فَاتَّبَعُوهُمْ مُشْرِقِينَ ﴿٣٥﴾

62. Dhe kur të dyja grupet e panë njëra-tjetrën, shokët e Musait thanë: “Na zunë, përnjëmend!”

فَلَمَّا تَرَاءَ الْجَمْعَانِ قَالَ أَصْحَابُ مُوسَىٰ  
إِنَّا لَمُدْرِكُونَ ﴿٣٦﴾

63. (Musai) tha: “Kurrsesi! E kam Zotin tim me mua. Ai patjetër do të më përudhë.”

قَالَ كَلَّا ۚ إِنَّ مَعِيَ رَبِّي سَيَهْدِينِ ﴿٣٧﴾

64. Atëherë i shpallëm Musait: “Bjeri detit me shkopin tënd”, e (deti) u ça, ashtu sikur çdo pjesë të ishte ndonjë kodër e madhe!

فَأَوْحَيْنَا إِلَىٰ مُوسَىٰ أَنْ اصْرِبْ بِعَصَاكَ  
الْبَحْرَ ۗ فَأَنْفَلَقَ فَكَانَ كُلُّ فِرْقٍ كَالضَّوْدِ  
الْعَظِيمِ ۝٤٤

65. Në atë vend i afruam të tjerët (pra, ushtrinë).

وَأَرْزَلْنَا مَاءَ الْآخِرِينَ ۝٤٥

66. E shpëtuan Musain dhe të gjithë ata që ishin me të.

وَأَنْجَيْنَا مُوسَىٰ وَمَنْ مَعَهُ أَجْمَعِينَ ۝٤٦

67. Më pas, të tjerët i fundosëm.<sup>4</sup>

ثُمَّ أَغْرَقْنَا الْآخِرِينَ ۝٤٧

68. Njëmend, në këtë ka një shenjë. Dhe shumica prej tyre nuk u bënë besimtarë.

إِنَّ فِي ذَٰلِكَ لَآيَةً ۗ وَمَا كَانَ أَكْثَرُهُمْ  
مُؤْمِنِينَ ۝٤٨

69. Dhe sigurisht, Zoti yt është Mbizotëruesi, Mëshirëbërësi.

وَإِنَّ رَبَّكَ لَهُوَ الْعَزِيزُ الرَّحِيمُ ۝٤٩

70. Lexoju atyre edhe lajmin e Ibrahimit.

وَإِذْ نَادَىٰ رَبَّهُمْ نَبَأُ ابْرَاهِيمَ ۝٥٠

71. Kur ai i tha babait dhe popullit të tij: “Çfarë adhuroni ju?”

إِذْ قَالَ لِأَبِيهِ وَقَوْمِهِ مَا تَعْبُدُونَ ۝٥١

72. Ata thanë: “Adhurojmë idhuj dhe rrimë ulur përpara tyre.”

قَالُوا نَعْبُدُ أَصْنَامًا فَنَظَّلُ لَهَا عَكْفِينَ ۝٥٢

73. Ai tha: “A ju dëgjojnë ata kur u luteni?”

قَالَ هَلْ يَسْمَعُونَكُمُ إِذْ تَدْعُونَ ۝٥٣

4. Këto ajete tregojnë sesi *Hazret Musai*<sup>as</sup> kapërceu detin në vendin ku bashkohet lumi Nil me detin. Nganjëherë ujërat e Nilit kanë dallgë të mëdha dhe duket sikur uji vjen në formë muri. Po kështu, edhe deti ngrihet për shkak të dallgëve të mëdha për arsye të ndryshme. Allahu i Madhërishëm e solli *Hazret Musain* dhe popullin e tij në këtë pozicion gjeografik në një kohë kur të dyja ujërat nuk ishin bashkuar ende, në mënyrë që ata të kalonin pa pengesë. Por mbrapa, ata po ndiqeshin nga Faraoni dhe ushtria e tij. Dhe deri në momentin kur Faraoni dhe ushtria e tij ishin futur në atë vend, ujërat u rikthyen dhe kështu ata u fundosën nga dallgët e mëdha që u erdhën nga të dyja anët.

74. A ju bëjnë dobi (dhe) a ju dëmtojnë?” أَوْ يَنْفَعُونَكُمْ أَوْ يَضُرُّونَ ﴿٧٤﴾
75. Ata thanë: “Jo, por ne pamë baballarët tanë që kështu bënin.” قَالُوا بَلْ وَجَدْنَا آبَاءَنَا كَذَلِكَ يَفْعَلُونَ ﴿٧٥﴾
76. Ai tha: “A keni menduar se çfarë keni adhuruar, قَالَ أَفَرَأَيْتُمْ مَا كُنْتُمْ تَعْبُدُونَ ﴿٧٦﴾
77. ju dhe baballarët tuaj të parë?” أَنْتُمْ وَ آبَاؤُكُمْ الْأَقْدَمُونَ ﴿٧٧﴾
78. Njëmend, ata i kam armiq, por jo Zotin e botëve. فَالَهُمْ عَدُوِّيَ إِلَّا رَبُّ الْعَالَمِينَ ﴿٧٨﴾
79. Ai që më krijoi, e pikërisht Ai më udhëzon; الَّذِي خَلَقَنِي فَهُوَ يَهْدِينِ ﴿٧٩﴾
80. Ai që më ushqen dhe më jep për të pirë; وَالَّذِي هُوَ يُطْعِمُنِي وَيَسْقِينِ ﴿٨٠﴾
81. Dhe kur sëmurem, pikërisht Ai më shëron; وَإِذَا مَرِضْتُ فَهُوَ يَشْفِينِ ﴿٨١﴾
82. Ai që më jep vdekje dhe më pas do të më ringjallë. وَالَّذِي يُمَيِّتُنِي ثُمَّ يُحْيِينِ ﴿٨٢﴾
83. Ai prej të cilit shpresoj se do të më falë gjynahet Ditën e Gjykimit. وَالَّذِي أَطْمَعُ أَنْ يَغْفِرَ لِي خِطِيئِي يَوْمَ الدِّينِ ﴿٨٣﴾
84. O Zoti im! Më dhuro urtësinë dhe më bashko me të dëlirët! رَبِّ هَبْ لِي حُكْمًا وَوَالْحَقِّي بِالصَّالِحِينَ ﴿٨٤﴾
85. Te të mëvonshmit më bëj gjuhë të së vërtetës! وَاجْعَلْ لِي لِسَانَ صِدْقٍ فِي الْآخِرِينَ ﴿٨٥﴾
86. Më bëj ndër trashëgimtarët e xhenetit bekimplotë! وَاجْعَلْنِي مِنْ وَرَثَةِ جَنَّةِ النَّعِيمِ ﴿٨٦﴾

87. Fal babanë tim, se ai me siguri është ndër të devijuarit!

وَاعْفِرْ لِيَّ إِنَّهُ كَانَ مِنَ الصَّالِحِينَ ﴿٨٧﴾

88. Dhe mos më poshtëro ditën kur do të ringjallen (të gjithë)!

وَلَا تُخْزِنِي يَوْمَ يُبْعَثُونَ ﴿٨٨﴾

89. Ditën kur nuk do të sjellin dot dobi as pasuria e as djemtë.

يَوْمَ لَا يَنْفَعُ مَالٌ وَلَا بَنُونَ ﴿٨٩﴾

90. Por (do të përfitojë) vetëm ai që vjen tek Allahu me zemër të dëlirë.

إِلَّا مَنْ أَتَى اللَّهَ بِقَلْبٍ سَلِيمٍ ﴿٩٠﴾

91. Dhe kur xheneti do t'u afrohet të druajturve (ndaj Zotit).

وَأَزَلَّتِ الْجَنَّةُ لِلْمُتَّقِينَ ﴿٩١﴾

92. Kurse xhehenemi do t'u silltet përballë të devijuarve.

وَبَرَزَتِ الْجَحِيمُ لِلْغَوِينَ ﴿٩٢﴾

93. Dhe do t'u thuhet: “Ku janë ata që i adhuronit,

وَقِيلَ لَهُمْ أَيْنَمَا كُنْتُمْ تَعْبُدُونَ ﴿٩٣﴾

94. përveç Allahut? A mund t'ju ndihmojnë, ose, a mund të hakmerren?!”

مِنْ دُونِ اللَّهِ ۗ هَلْ يَنْصَرُونَكَ أَوْ يَنْصَرُونَ ﴿٩٤﴾

95. Atëherë do të rrëzohen në të për fytyrash ata dhe rebelët,

فَكَبِكَبُوا فِيهَا هُمْ وَالْعَاُونَ ﴿٩٥﴾

96. si dhe krejt ushtritë e djallit.

وَجُودُ إِلْيَاسَ أَجْمَعُونَ ﴿٩٦﴾

97. Ndërsa grinden me njëri-tjetrin atje, ata do të thonë:

قَالُوا وَهُمْ فِيهَا يَخْتَصِمُونَ ﴿٩٧﴾

98. “Për Allahun! Kemi qenë përnjëmend në devijim të qartë,

تَاللَّهِ إِنَّ كُنَّا لَفِي ضَلَالٍ مُّبِينٍ ﴿٩٨﴾

99. kur ju barazonim me Zotin e botëve!

إِذْ نُسَوِّكُمْ بِرَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿٩٩﴾

100. Dhe ne nuk na kanë devijuar askush, përveçse fajtorët.

وَمَا أَصَلْنَا إِلَّا الْمُجْرِمُونَ ﴿١٠٠﴾

101. Dhe (tani) nuk kemi më asnjë ndërmjetësues.

فَمَا لَنَا مِنْ شَافِعِينَ ﴿١٠١﴾

102. E as shok të ngushtë.

وَلَا صَدِيقٍ حَمِيمٍ ﴿١٠٢﴾

103. Eh, sikur të kishim një kthim (mbrapa), do të bëheshim besimtarë.”

فَلَوْ أَنَّ لَنَا كَرَّةً فَنَكُونُ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ ﴿١٠٣﴾

104. Njëmend, në këtë ka një shenjë. Dhe shumica prej tyre nuk u bënë besimtarë.

إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَةً ۖ وَمَا كَانَ أَكْثَرُهُمْ مُؤْمِنِينَ ﴿١٠٤﴾

105. Dhe sigurisht, Zoti yt është Triumfuesi, Mëshirëbërësi.

بَعِّثْ وَإِنَّ رَبَّكَ لَهُوَ الْعَزِيزُ الرَّحِيمُ ﴿١٠٥﴾

106. Populli i Nuhut i quajti gënjeshtarë të dërguarit.<sup>5</sup>

كَذَّبَتْ قَوْمَ نُوحٍ الْمُرْسَلِينَ ﴿١٠٦﴾

107. Kur atyre u tha vëllai i tyre, Nuhu: “A nuk druheni?!”

إِذْ قَالَ لَهُمْ أَخُوهُمْ نُوحٌ أَلَا تَتَّقُونَ ﴿١٠٧﴾

108. Unë për ju jam i Dërguar i besueshëm.

إِنِّي لَكُمْ رَسُولٌ أَمِينٌ ﴿١٠٨﴾

109. Andaj, kini drojë ndaj Allahut dhe m'u bindni mua!

فَاتَّقُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا ﴿١٠٩﴾

110. Nuk ju kërkoj ndonjë shpërblim për këtë; shpërblimi im është vetëm te Zoti i botëve.

وَمَا أَسْأَلُكُمْ عَلَيْهِ مِنْ أَجْرٍ ۚ إِنْ أَجْرِيَ إِلَّا عَلَى رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿١١٠﴾

5. Popujt që janë përmendur në këtë sure, secilit prej tyre Zoti i Madhërishtëm i kishte dërguar nga një të dërguar, megjithatë, në këto ajete (në ajetet nr. 106, 124, 142, 161 dhe 177), në mënyrë të përsëritur Zoti thotë se ata i kanë refuzuar të Dërguarit, pra në shumës. Kjo për arsye se ai që refuzon një profet, pra Profetin e kohës së tij, është sikur të ketë refuzuar të gjithë Profetët, sepse të gjithë të Dërguarit dhe Profetët vijnë nga i njëjti Zot dhe sjellin të vërteta themelore dhe absolute. Lexoni edhe 54:24.

111. Prandaj, kini drojë ndaj Allahut dhe m'u bindni mua!"

فَاتَّقُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا<sup>ط</sup>

112. Ata thanë: "A të besojmë ty, ndërkohë që ty të ndoqën të ulëtit?"

قَالُوا أَلْأَنْتَ الَّذِي كَذَّبْتَنَا<sup>ط</sup>

113. Ai tha: "E çfarë di unë se çfarë bënin ata?"

قَالَ وَمَا عَلِمْتُ بِمَا كَانُوا يَعْمَلُونَ<sup>ج</sup>

114. Llogaria e tyre i takon vetëm Zotit tim. Sikur të kuptonit!

إِنْ حِسَابُهُمْ إِلَّا عَلَىٰ رَبِّي لَوَ تَشْعُرُونَ<sup>ج</sup>

115. Unë nuk mund t'i përzë besimtarët.

وَمَا أَنَا بِطَارِدِ الْمُؤْمِنِينَ<sup>ج</sup>

116. Jam vetëm një alarmues i qartë."

إِن أَنَا إِلَّا نَذِيرٌ مُّبِينٌ<sup>ط</sup>

117. Ata thanë: "Po nuk u tërhoqe, o Nuh, me siguri do të jesh nga ata që gurëzohen."

قَالُوا لَئِن لَّمْ تَكُنْ مِنَّا فَتُنَكَّرْ<sup>ط</sup>  
الْمَرْجُومِينَ<sup>ط</sup>

118. Ai tha: "O Zoti im! Populli im më quajti gënjeshtar!"

قَالَ رَبِّ إِنِّي كُذِّبْتُ<sup>ج</sup>

119. Prandaj, bëj gjykim të qartë midis meje dhe atyre dhe më shpëto mua dhe besimtarët që janë me mua!"

فَأَفْتَحْ بَيْنِي وَبَيْنَهُمْ فَتْحًا وَنَجِّنِي<sup>ط</sup>  
وَمَنْ مَعِيَ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ<sup>ط</sup>

120. Atëherë, Ne e shpëtuam atë dhe ata që ishin me të në anijen e mbushur.

فَأَنْجِئْنَاهُ وَمَنْ مَعَهُ فِي الْفُلِّ الْمُسْحُونِ<sup>ج</sup>

121. Më pas, të tjerët që mbetën, i fundosëm.

ثُمَّ أَعْرَفْنَا بَعْدَ الْبُقْعَيْنِ<sup>ط</sup>

122. Njëmend, në këtë ka një shenjë. Dhe shumica prej tyre nuk u bënë besimtarë.

إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَةً<sup>ط</sup> وَمَا كَانَ أَكْثَرَهُمْ<sup>ط</sup>  
مُؤْمِنِينَ<sup>ط</sup>

123. Dhe sigurisht, Zoti yt është Mbizotëruesi, Mëshirëbërësi.

وَإِنَّ رَبَّكَ لَهُوَ الْعَزِيزُ الرَّحِيمُ ﴿١٢٣﴾

124. (Edhe) adët i quajtën gënjeshtarë të dërguarit.

كَذَّبَتْ عَادٌ الْمُرْسَلِينَ ﴿١٢٤﴾

125. Kur vëllai i tyre, Hudi, u tha: “A nuk druheni?”

إِذْ قَالَ لَهُمُ أَخُوهُمْ هُودٌ أَلَا تَتَّقُونَ ﴿١٢٥﴾

126. Unë për ju jam i Dërguar i besueshëm.

إِنِّي لَكُمْ رَسُولٌ أَمِينٌ ﴿١٢٦﴾

127. Andaj, kini drojë ndaj Allahut dhe m’u bindni mua!

فَاتَّقُوا اللَّهَ وَاطِيعُونَ ﴿١٢٧﴾

128. Nuk ju kërkoj ndonjë shpërblim për këtë; shpërblimi im është vetëm te Zoti i botëve.

وَمَا أَسْأَلُكُمْ عَلَيْهِ مِنْ أَجْرٍ ۚ إِنْ أَجْرِيَ إِلَّا عَلَىٰ رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿١٢٨﴾

129. A ngrini kot më kot përmendore (të madhështisë suaj) në çdo lartësi,

أَتَتَّبِعُونَ كُلَّ رِيحٍ أَيَّهَا تَعْبُؤُونَ ﴿١٢٩﴾

130. dhe ndërtoni pallate që të rroni përjetësisht;

وَتَتَّخِذُونَ مَصَانِعَ لَعَلَّكُمْ تَخْلُدُونَ ﴿١٣٠﴾

131. dhe kur shtrëngoni (dikë, e) shtrëngoni dhunshëm?!

وَإِذَا بَطِشْتُمْ بَطِشْتُمْ جَبَّارِينَ ﴿١٣١﴾

132. Kini drojë ndaj Allahut dhe m’u bindni mua!

فَاتَّقُوا اللَّهَ وَاطِيعُونَ ﴿١٣٢﴾

133. Kijeni drojë ndaj Atij që ju ndihmoi përmes asaj që dini.

وَاتَّقُوا الَّذِي أَمَدَّكُمْ بِمَا تَعْلَمُونَ ﴿١٣٣﴾

134. Ju ndihmoi me anë të bagëtive e fëmijëve;

أَمَدَّكُمْ بِأَنْعَامٍ وَبَنِينَ ﴿١٣٤﴾

135. me anë të kopshteve e burimeve.

وَجَنَّاتٍ وَغَيْرِهَا ﴿١٣٥﴾

136. Unë frikësohem për ju nga ndëshkimi i një dite të rëndë.”

إِنِّي أَخَافُ عَلَيْكُمْ عَذَابَ يَوْمٍ عَظِيمٍ ۝٣٦

137. Ata thanë: “Njëlloj është për ne, në daç na këshillon, në daç nuk na këshillon.

قَالُوا سَوَاءٌ عَلَيْنَا أَوَعَضْتَ أَمْ لَمْ تَكُنْ مِنَ الْوَعِظِينَ ۝٣٧

138. Këto janë vetëm zakonet e të parëve (që na mëson ti)

إِنْ هَذَا إِلَّا حُلُقُ الْأَوَّلِينَ ۝٣٨

139. dhe ne nuk do të ndëshkohemi.”

وَمَا نَحْنُ بِمُعَذَّبِينَ ۝٣٩

140. Pra, ata e cilësuan gënjeshtar, atëherë Ne i shkatërruam. Njëmend, në këtë ka një shenjë. Dhe shumica prej tyre nuk u bënë besimtarë.

فَكَذَّبُوهُ فَأَهْلَكْنَاهُمْ ۗ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَةً ۗ وَمَا كَانَ أَكْثَرُهُمْ مُؤْمِنِينَ ۝٤٠

141. Dhe sigurisht, Zoti yt është Mbizotëruesi, Mëshirëbërësi.

وَإِنَّ رَبَّكَ لَهُوَ الْعَزِيزُ الرَّحِيمُ ۝٤١

142. (Edhe) themudët i quajtën gënjeshtarë të dërguarit.

كَذَّبَتْ ثَمُودُ الْمُرْسَلِينَ ۝٤٢

143. Kur vëllai i tyre, Salihu, u tha: “A nuk druheni?

إِذْ قَالَ لَهُمْ أَخُوهُمْ صَالِحٌ أَلَا تَتَّقُونَ ۝٤٣

144. Unë për ju jam i Dërguar i besueshëm.

إِنِّي لَكُمْ رَسُولٌ أَمِينٌ ۝٤٤

145. Andaj, kini drojë ndaj Allahut dhe m’u bindni mua!

فَاتَّقُوا اللَّهَ وَاطِيعُونَ ۝٤٥

146. Nuk ju kërkoj ndonjë shpërblim për këtë; shpërblimi im është vetëm te Zoti i botëve.

وَمَا أَسْأَلُكُمْ عَلَيْهِ مِنْ أَجْرٍ ۗ إِنْ أَجْرِيَ إِلَّا عَلَى رَبِّ الْعَالَمِينَ ۝٤٦

147. A do të liheni këtu kështu të lirë, vallë,

أَتُنزِّلُكُمْ فِي مَا هُمْنَا أَمِينٌ ۝٤٧



148. nëpër kopshte, e (nëpër) burime;

فِي جَبَّتٍ وَعَيُْونٍ ﴿١٤٨﴾

149. nëpër ara, e (nëpër) hurma me plot kalaveshë?!

وَزُرُوعٍ وَخَلٍ طَلَعَهَا هَٰضِمٌ ﴿١٤٩﴾

150. Ju ndërtoni shtëpitë në male me mjeshtëri.

وَتَتَّحْتُونَ مِنَ الْجِبَالِ بُيُوتًا  
فُرْهِينَ ﴿١٥٠﴾

151. Kijeni drojën ndaj Allahut dhe mua më ndiqni.

فَاتَّقُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا ﴿١٥١﴾

152. Mos ndiqni urdhrat e atyre që i kanë shkelur kufijtë,

وَلَا تُطِيعُوا أَمْرَ الْمُسْرِفِينَ ﴿١٥٢﴾

153. të cilët bëjnë çrregullim në tokë dhe nuk janë përmirësues.”

الَّذِينَ يُفْسِدُونَ فِي الْأَرْضِ وَلَا  
يُصْلِحُونَ ﴿١٥٣﴾

154. Ata thanë: “Ty me gjithë mend të kanë bërë magji.

قَالُوا إِنَّمَا أَنْتَ مِنَ الْمَسْحَرِينَ ﴿١٥٤﴾

155. Nuk je asgjë, përveçse një njeri sikur ne. Sill ndonjë shenjë, në qoftë se je i vërtetë.”

مَا أَنْتَ إِلَّا بَشَرٌ مِّثْلُنَا ۗ فَأْتِ بآيَةٍ إِنْ كُنْتَ  
مِنَ الصَّٰدِقِينَ ﴿١٥٥﴾

156. (Salihu) tha: “Kjo është deveja, së cilës i caktohet një kohë për të pirë ujë, edhe ju do të keni një ditë të caktuar për të pirë.

قَالَ هَذِهِ نَاقَةٌ لَهَا شِرْبٌ وَلَكُمْ شِرْبُ  
يَوْمٍ مَّعْلُومٍ ﴿١٥٦﴾

157. Mos e prekni me të keqe, se ndryshe do t’ju zërë ndëshkimi i një dite të rëndë.”

وَلَا تَمْسُوهَا بِسُوءٍ فَيَأْخُذَكُمْ عَذَابُ  
يَوْمٍ عَظِيمٍ ﴿١٥٧﴾

158. Ata ia prenë këmbët (dhe e therën). Më pas mbetën të penduar.

فَعَقَرُوهَا فَاصْبَحُوا نَدِيمِينَ ﴿١٥٨﴾

159. Pra, i zuri ndëshkimi. Sigurisht, në të ka një shenjë. Dhe shumica prej tyre nuk besonin.

فَأَخَذَهُمُ الْعَذَابُ ۗ إِنَّ فِي ذَٰلِكَ لآيَةً  
وَمَا كَانَ أَكْثَرُهُمْ مُّؤْمِنِينَ ﴿١٥٩﴾

160. Dhe sigurisht, Zoti yt është Mbizotëruesi, Mëshirëbërësi.

وَإِنَّ رَبَّكَ لَهُوَ الْعَزِيزُ الرَّحِيمُ ﴿١٦٠﴾

161. (Edhe) populli i Lutit i quajti gënjeshtarë të dërguarit.

كَذَّبَتْ قَوْمُ لُوطٍ الْمُرْسَلِينَ ﴿١٦١﴾

162. Kur vëllai i tyre, Luti, u tha: “A nuk druheni?”

إِذْ قَالَ لَهُمُ أَخُوهُمْ لُوطٌ أَلَا تَتَّقُونَ ﴿١٦٢﴾

163. Unë për ju jam i Dërguar i besueshëm.

إِنِّي لَكُمْ رَسُولٌ أَمِينٌ ﴿١٦٣﴾

164. Andaj, kini drojë ndaj Allahut dhe m’u bindni mua!

فَاتَّقُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا أَمْرًا ﴿١٦٤﴾

165. Nuk ju kërkoj ndonjë shpërblim për këtë; shpërblimi im është vetëm te Zoti i botëve.

وَمَا أَسْأَلُكُمْ عَلَيْهِ مِنْ أَجْرٍ ۚ إِنْ أَجْرِيَ إِلَّا عَلَىٰ رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿١٦٥﴾

166. A shkoni me meshkujt në krejt botën,

أَتَأْتُونَ الذُّكْرَانَ مِنَ الْعَالَمِينَ ﴿١٦٦﴾

167. dhe i lini ato që Zoti juaj ka krijuar për ju si bashkëshortet tuaja?! Në të vërtetë, jeni popull i dalë nga kufijtë.”

وَتَذَرُونَ مَا خَلَقَ لَكُمْ رَبُّكُمْ مِنْ أَزْوَاجِكُمْ ۗ بَلْ أَنْتُمْ قَوْمٌ عَادُونَ ﴿١٦٧﴾

168. Ata thanë: “Po nuk u tërhoqe, o Lut, ty patjetër do të të përzëmë (nga vendi)!”

قَالُوا لَئِنْ لَمْ تَنْتَهِ يَلُوطُ لَتَكُونَنَّ مِنَ الْمُخْرَجِينَ ﴿١٦٨﴾

169. (Luti) tha: “Sigurisht, jam shumë i distancuar nga veprimet tuaja.

قَالَ إِنِّي لِعَمَلِكُمْ مِنَ الْقَالِينَ ﴿١٦٩﴾

170. O Zoti im! Më shpëto mua dhe familjen time nga ajo që ata bëjnë!”

رَبِّ نَجِّنِي وَأَهْلِي مِمَّا يَعْمَلُونَ ﴿١٧٠﴾

171. Atëherë, Ne e shpëtuam atë dhe të gjithë nga familja e tij;

فَنَجَّيْنَاهُ وَأَهْلَهُ أَجْمَعِينَ ﴿١٧١﴾

172. me përjashtim të një plake, (që mbeti) mes të mbeturve.

إِلَّا عَجُوزًا فِي الْغَابِرِينَ ﴿٧٦﴾

173. Më pas, gjithë të tjerët i shkatërroam.

ثُمَّ دَهَرْنَا الْأَخْرِينَ ﴿٧٧﴾

174. Lëshuam një shi mbi ta. Eh sa i keq ishte shiu për të parajmëruarit!

وَأَمْطَرْنَا عَلَيْهِمْ مَطَرًا ۖ فَسَاءَ مَطَرُ الْمُنذَرِينَ ﴿٧٨﴾

175. Sigurisht, në të ka një shenjë. Dhe shumica prej tyre nuk besonin.

إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَةً ۖ وَمَا كَانَ أَكْثَرُهُمْ مُؤْمِنِينَ ﴿٧٩﴾

176. Dhe sigurisht, Zoti yt është Mbizotëruesi, Mëshirëbërësi.

وَإِنَّ رَبَّكَ لَهُو الْعَزِيزُ الرَّحِيمُ ﴿٨٠﴾

177. (Edhe) banorët e pyjeve i quajtën gënjeshtarë të dërguarit.<sup>6</sup>

كَذَّبَ أَصْحَابُ لَيْكَةِ الْمُرْسَلِينَ ﴿٨١﴾

178. Kur Shuajbi u tha atyre: “A nuk druheni?

إِذْ قَالَ لَهُمْ شُعَيْبٌ أَلَا تَتَّقُونَ ﴿٨٢﴾

179. Unë për ju jam i Dërguar i besueshëm.

إِنِّي لَكُمْ رَسُولٌ أَمِينٌ ﴿٨٣﴾

180. Andaj, kini drojë ndaj Allahut dhe m’u bindni mua!

فَاتَّقُوا اللَّهَ وَاطِيعُونَ ﴿٨٤﴾

181. Nuk ju kërkoj ndonjë shpërblim për këtë; shpërblimi im është vetëm te Zoti i botëve.

وَمَا أَسْأَلُكُمْ عَلَيْهِ مِنْ أَجْرٍ ۗ إِنْ أَجْرِيَ إِلَّا عَلَىٰ رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿٨٥﴾

182. Jepni të plotë masën dhe mos u bëni nga ata që e pakësojnë.

أَوْفُوا الْكَيْلَ وَلَا تَكُونُوا مِنَ الْمُخْسِرِينَ ﴿٨٦﴾

6. Banorët e pyjeve është emri i dytë i popullit të Hazret Shuajbit<sup>as</sup>. Fjala arabe *ejke* do të thotë pyll i madh; një pyll ku ka shumë hide dhe mana të egra. Mundet që Medjeni kishte një pyll të madh që i kishte me shumicë këto dy lloje pemësh.

183. Dhe peshoni me peshore të drejtë.

وَزِنُوا بِالْقِسْطِ الْمُسْتَقِيمِ ﴿١٨٣﴾

184. Mos ua pakësoni njerëzve gjërat e tyre dhe mos bridhni në tokë duke bërë çrregullime.

وَلَا تَبْخَسُوا النَّاسَ أَشْيَاءَهُمْ وَلَا تَعْمُوا فِي الْأَرْضِ مُفْسِدِينَ ﴿١٨٤﴾

185. Kini druajtjen ndaj Atij që ju krijoi ju dhe brezat e mëparshëm.”

وَاتَّقُوا الَّذِي خَلَقَكُمْ وَالْحِجْلَةَ الْأُولَىٰ ﴿١٨٥﴾

186. Ata thanë: “Ty me gjithë mend të kanë bërë magji.

قَالُوا إِنَّمَا أَنْتَ مِنَ الْمَسْحُورِينَ ﴿١٨٦﴾

187. Nuk je asgjë, përveçse një njeri sikur ne dhe ne besojmë se vërtet je gënjeshtar.

وَمَا أَنْتَ إِلَّا بَشَرٌ مِّثْلُنَا وَإِنْ نَطُّتْكَ لَمِنَ الْكَاذِبِينَ ﴿١٨٧﴾

188. Na lësho pra ca copa prej qiellit, nëse je i vërtetë.”

فَأَسْقِطْ عَلَيْنَا كِسْفًا مِّنَ السَّمَاءِ إِنْ كُنْتَ مِنَ الصَّادِقِينَ ﴿١٨٨﴾

189. (Shuajbi) tha: “Zoti im e di më së miri se çfarë bëni ju.”

قَالَ رَبِّيَ أَعْلَمُ بِمَا تَعْمَلُونَ ﴿١٨٩﴾

190. Pra, ata e quajtën gënjeshtar dhe i zuri ndëshkimi i një dite hijerëndë. Pa dyshim, ai qe ndëshkim i një dite të rëndë.

فَكَذَّبُوهُ فَأَخَذَهُمْ عَذَابٌ يَوْمِ الظُّلَّةِ ۗ إِنَّهُ كَانَ عَذَابٌ يَوْمٍ عَظِيمٍ ﴿١٩٠﴾

191. Sigurisht, në të ka një shenjë. Dhe shumica prej tyre nuk besonin.

إِنَّ فِي ذَٰلِكَ لَآيَةً ۗ وَمَا كَانَ أَكْثَرُهُمْ مُّؤْمِنِينَ ﴿١٩١﴾

192. Dhe sigurisht, Zoti yt është Mbizotëruesi, Mëshirëbërësi.

وَإِنَّ رَبَّكَ لَهُوَ الْعَزِيزُ الرَّحِيمُ ﴿١٩٢﴾

193. Pa dyshim, ky (Libër) është zbritur prej Zotit të botëve.

وَإِنَّهُ لَتَنْزِيلُ رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿١٩٣﴾

194. Të cilin e solli Shpirti i besueshëm

نَزَّلَ بِهِ الرُّوحَ الْأَمِينُ ﴿١٩٤﴾

195. Mbi zemrën tënde, që ti të jesh alarmues.<sup>7</sup>

عَلَى قَلْبِكَ لِتَكُونَ مِنَ الْمُنذِرِينَ ﴿١٩٥﴾

196. Në gjuhën arabe të qartë.

بِلِسَانٍ عَرَبِيٍّ مُبِينٍ ﴿١٩٦﴾

197. Dhe sigurisht, ky (përmendet) edhe në skriptet e para.

وَأِنَّهُ لَفِي زُجُرِ الْأَوَّلِينَ ﴿١٩٧﴾

198. A nuk është një shenjë për ta që dijetarët e bijve të Izraelit e dinë këtë?!

أَوَلَمْ يَكُنْ لَهُمْ آيَةٌ أَنْ يَعْلَمَهُ عُلَمَاءُ بَنِي إِسْرَائِيلَ ﴿١٩٨﴾

199. Po sikur ta zbrisnim atë mbi ndonjë nga jo-arabët (pra, mbi dikë që nuk është elokuent),

وَلَوْ نَزَّلْنَاهُ عَلَى بَعْضِ الْأَعْجَمِينَ ﴿١٩٩﴾

200. Dhe ai t'ua kishte lexuar, ata kurrë nuk do ta besonin.

فَقَرَأَهُ عَلَيْهِمْ مَا كَانُوا بِهِ مُؤْمِنِينَ ﴿٢٠٠﴾

201. Ne kështu e kemi ngulitur (mosbesimin) në zemrat e keqbërësve.

كَذَلِكَ سَلَكْنَاهُ فِي قُلُوبِ الْمُجْرِمِينَ ﴿٢٠١﴾

202. Ata nuk do ta besojnë atë, derisa nuk shohin ndëshkimin e dhimbshëm.

لَا يُؤْمِنُونَ بِهِ حَتَّى يَرَوْا الْعَذَابَ الْأَلِيمَ ﴿٢٠٢﴾

203. Në atë mënyrë që ajo t'u vijë befaz dhe ata të jenë të pavëmendshëm.

فَيَأْتِيهِمْ بَغْتَةً وَهُمْ لَا يَشْعُرُونَ ﴿٢٠٣﴾

204. Atëherë do të thonë: “A do të na jepet (akoma) afat?”

فَيَقُولُوا هَلْ نَحْنُ مُنْظَرُونَ ﴿٢٠٤﴾

7. Ajetet 193 – 195: Kurani i Shenjtë u zbrit përmes *Hazret Xhibrailit*<sup>as</sup>, që quhet edhe *Ruhul-Emin* (Shpirti i besueshëm). Pra, Zoti i Madhërishtëm e zbriti Kurandin përmes *Hazret Xhibrailit*<sup>as</sup>, mbi zemrën e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>.

205. Si? A e kërkonin këta me nxitim ndëshkimin Tonë?!

أَفِعْدَابِنَا يَسْتَحْجِلُونَ ﴿٢٠٥﴾

206. A ke menduar, nëse Ne i lëmë të përfitojnë edhe disa vjet;

أَفَرَأَيْتَ إِنْ مَتَّعْنَاهُمْ سِنِينَ ﴿٢٠٦﴾

207. pastaj t'u vijë ajo që u ishte paralajmëruar?

ثُمَّ جَاءَهُمْ مَا كَانُوا يُوعَدُونَ ﴿٢٠٧﴾

208. Fitimet e tyre që u vinin nuk do t'u vlejnjë dot.

مَا آغْنَىٰ عَنْهُمْ مَا كَانُوا يَمْتَنِعُونَ ﴿٢٠٨﴾

209. Ne nuk shkatërruam asnjë vendbanim, përveçse (deri atëherë) atij i kishin ardhur alarmuesit.

وَمَا أَهْلَكْنَا مِنْ قَرْيَةٍ إِلَّا لَهَا مُنْذِرُونَ ﴿٢٠٩﴾

210. (Kjo është) kujtesë! Ne nuk kemi qenë kurrë dhunues.

ذِكْرِي ۖ وَمَا كُنَّا ظَالِمِينَ ﴿٢١٠﴾

211. Me këtë (Kuran) nuk kanë zbritur djajtë.

وَمَا تَنَزَّلَتْ بِهِ الشَّيَاطِينُ ﴿٢١١﴾

212. Dhe ata as nuk guxojnë dhe as nuk kanë mundësi.

وَمَا يَنْبَغِي لَهُمْ وَمَا يَسْتَطِيعُونَ ﴿٢١٢﴾

213. Njëmend, ata janë përzënë nga dëgjimi (i shpalljes së Zotit).

إِنَّهُمْ عَنِ السَّمْعِ لَمَعَرُؤُونَ ﴿٢١٣﴾

214. Prandaj, mos iu lut ndonjë të adhureshmi tjetër bashkë me Allahun, sepse do të bëhesh prej atyre që do të ndëshkohen.

فَلَا تَدْعُ مَعَ اللَّهِ إِلَهًا آخَرَ فَتَكُونَ مِنَ الْمُعَذَّبِينَ ﴿٢١٤﴾

215. Dhe paralajmëro të afërmit nga fisi yt.

وَأَنْذِرْ عَشِيرَتَكَ الْأَقْرَبِينَ ﴿٢١٥﴾

216. Ul krahun tënd për ata që të ndjekin nga besimtarët.

وَاحْفَظْ جَنَاحَكَ لِمَنِ اتَّبَعَكَ مِنَ  
الْمُؤْمِنِينَ ﴿١١٦﴾

217. E nëse të kundërvihen, thuaj: Unë jam i distancuar nga ajo që bëni.

فَإِنْ عَصَوْكَ فَقُلْ إِنِّي بَرِيءٌ مِّمَّا  
تَعْمَلُونَ ﴿١١٧﴾

218. Mbështetu te Mbizotëruesi, Mëshirëbërësi.

وَتَوَكَّلْ عَلَى الْعَزِيزِ الرَّحِيمِ ﴿١١٨﴾

219. Ai që të sheh kur ngrihesh;

الَّذِي يَرَاكَ حِينَ تَقُومُ ﴿١١٩﴾

220. dhe përpëlitjen tënde bashkë me ata që bëjnë sexhde.

وَتَقَلَّبَكَ فِي السَّجْدَيْنِ ﴿١٢٠﴾

221. Pa dyshim, Ai është Gjithëdëgjuesi, i Gjithëdijshmi.

إِنَّهُ هُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ ﴿١٢١﴾

222. A t'ju tregoj për atë, të cilit shpesh i zbresin djajtë?

هَلْ أُنَبِّئُكُمْ عَلَىٰ مَنْ نَزَّلَ الشَّيْطَانُ ﴿١٢٢﴾

223. Ata zbresin mbi çdo shpifës (dhe) mëkatar të madh.

نَزَّلَ عَلَىٰ كُلِّ أَفَّاكٍ أَثِيمٍ ﴿١٢٣﴾

224. Këta e mbajnë veshin (te djajtë) dhe shumica e tyre janë gënjeshtarë.

يُلْقُونَ السَّمْعَ وَأَكْثُرُهُمْ كَاذِبُونَ ﴿١٢٤﴾

225. Dhe për sa u përket poetëve, të devijuarit i ndjekin ata.

وَالشُّعْرَاءُ يَتَّبِعُهُمُ الْغَاوُونَ ﴿١٢٥﴾

226. A nuk e pe që ata vërtiten në çdo luginë?

أَلَمْ تَرَ أَنَّهُمْ فِي كُلِّ وَادٍ يَهِيمُونَ ﴿١٢٦﴾

227. Dhe thonë atë që vetë nuk e bëjnë.

وَأَنَّهُمْ يَقُولُونَ مَا لَا يَفْعَلُونَ ﴿١٢٧﴾

228. Përveç atyre që besuan, bënë të mira, përkujtuan shumë Allahun dhe luftuan pasi ishin dhunuar. Dhe ata që dhunuan, së shpejti do të mësojnë në cilin vend do të kthehen.

إِلَّا الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ وَذَكَرُوا  
 اللَّهَ كَثِيرًا وَانْتَصَرُوا مِنْ بَعْدِ مَا ظَلَمُوا  
 وَسَيَعْلَمُ الَّذِينَ ظَلَمُوا أَيَّ مُنْقَلَبٍ

سَيَقْبَلُونَ ﴿٢٢٨﴾



## Surja 27 – En-Neml

Kjo sure është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka nëntëdhjetë e katër ajete.

Surja En-Neml fillon me shkurtesat Ta.Sin, që do të thotë Tejjib dhe Semi' (I Pastër, Gjithëdëgjues).

Duke ndjekur me përpikëri rrugën e Allahut të Madhërishëm, edhe Profeti Muhammed<sup>savs</sup> është i Pastër, dhe mbi të Pastrin nuk zbresin djajtë. Prandaj, kjo vepër është Fjala e Zotit të Pastër, që është Urtilplotë, dhe që zbriti shpalljen e qartë dhe urtilpote mbi robin e Tij të pastër.

Pas kësaj, kjo sure përmend *Hazret Musain*<sup>as</sup>, duke thënë se Allahu i Madhërishëm përmes shpalljes së Tij, i bekon robërit e Vet. Kështu, në ajetin 9 thuhet se atyre robërve të Allahut që janë në kërkim të dritës, Allahu i Madhërishëm ua shfaq dritën e Tij dhe, në këtë mënyrë, i sjell drejt bekimeve.

Më pas flet për *Hazret Davudin*<sup>as</sup> dhe *Hazret Sulejmanin*<sup>as</sup>, përmendje e cila shpalos shumë nga shprehjet e Kuranit, duke çuar njeriun nga errësira në dritë. Por kjo temë ka një sërë ajetesh të shumëkuptimshme, të cilat i devijojnë të shtrembrit nga zemra edhe më thellë, dhe kështu ata nuk arrijnë dot të futen në brendinë e temës. Ajo që tërheq më shumë vëmendje është ajeti që flet për *të folurën e zogjve*. Sipas Kuranit të Shenjtë, *e folura e zogjve* është gjuha e atyre njerëzve që si zogjtë fluturojnë shpirtërisht në qiell, pra që komunikojnë në gjuhën qiellore. Nuk është i saktë mendimi se *Hazret Sulejmani*<sup>as</sup> dinte apo fliste “gjuhën” me të cilën zogjtë komunikojnë me njëri-tjetrin. Shumë ajete të kësaj sureje e largojnë këtë keqkuptim. Për shembull, në një ajet thuhet se populli i Nemlit po flisnin me njëri-tjetrin dhe *Hazret Sulejmani*<sup>as</sup> kuptoi fjalën e tyre. Tani, me fjalën Neml, nëse do të kuptojmë jo popullin e quajtur Neml, por milingonat a buburrecat, siç disa komentues të Kuranit e kanë kuptuar, dihet që milingonat nuk janë zogj. Atëherë, *Hazret Sulejmani* të cilit iu dhurua aftësia për të komunikuar me zogjtë, si arriti ta kuptonte edhe gjuhën e milingonave?!

Gjithashtu thuhet se njëra prej ushtrive të *Hazret Sulejmanit*<sup>as</sup> ishte edhe “ushtria e zogjve”, komandanti i së cilës u nis në kërkim të mbretëreshës së Sabasë dhe arriti ta gjente atë. Kur u kthye, duke treguar arsyen se pse kishte munguar, rrëfeu gjithçka që u bisedua në oborrin mbretëror të mbretëreshës së Sabasë. Pra, me demek, një zog po i kuptonte ata, ndërkohë që ata nuk flisnin gjuhën e zogjve, por atë të njerëzve. Sërish, kur ai i paraqiti mbretëreshës letrën e *Hazret Sulejmanit*<sup>as</sup>, kuptoi gjithë bisedën që u zhvillua mes saj dhe oborrtarëve të saj, bisedë e cila pa dyshim u bë në gjuhën e njeriut. Por, ku ka thënë Allahu në Kuran që edhe zogjtë kuptuan gjuhën e njerëzve?!

Shkurt, shumë ajete të kësaj sureje hedhin poshtë përrallat që njerëzit kanë krijuar rreth kësaj ngjarjeje, dhe japin kuptimin se robërit e Allahut flasin gjuhën qiellore.

Më pas vjen ngjarja që tregon sesi inxhinierët e *Hazret Sulejmanit*<sup>as</sup>, në zbatim të

urdhrit të tij, ndërtuan për mbretëreshën e Sabasë një pallat me dysheme prej qelqi, dhe bënë që nën të të rridhte ujë. Mbretëresha që tanimë e kishte pranuar epërsinë politike të *Hazret Sulejmanit*<sup>as</sup>, por ende nuk ishte tërhequr nga feja e saj e gabuar që adhuronte diellin, kur hyri në atë pallat, ngriti rrobat nga këmbët, nga frika se mos do t'i lageshin, pasi kujtoi se po futej në ujë, dhe nuk e kuptoi se po ecte mbi xham. Atëherë *Hazret Sulejmani*<sup>as</sup> i shpjegoi faktin se edhe dielli në dukje është burim i dritës, por ai furnizohet nga një burim tjetër drite që e ka rregulluar Allahu i Madhërishëm, dhe se ata që adhurojnë diellin, gabohen njësoj siç u gabua ajo kur shkeli dyshemenë. Mbretëresha e kuptoi realitetin e madh që kudo në natyrë ka vetëm shfaqje prej Zotit dhe se shfaqje të tjera nuk janë reale.

Në vijim përmenden njëri pas tjetrit Profetët, të cilët ngritën flamurin e Njeshmërisë së Zotit, kurse popujt e tyre që ishin idhujtarë njësoj si populli i Sabasë, vazhdimisht i refuzuan Profetët. Allahu i Madhërishëm e fali popullin e Sabasë për shkak se mbretëresha e tyre pranoi udhëzimin, por ata që ndoqën idhujtarinë në mënyrë të vazhdueshme, i shkatërroi.

Më pas, kjo sure ngre pyetjen se sistemin e zbritjes së ujit të kulluar në tokë, a mund të kishte rregulluar dikush tjetër përveç Zotit? Dhe e mbyll këtë temë duke pohuar se Allahu i Madhërishëm ngriti një pengesë mes deteve. Këto tema pa dyshim që i janë zbritur prej Zotit të Lartësuar Profetit Muhammed<sup>saws</sup> në formë uji shpirtëror, përndryshe në kohën e tij nuk ekzistonin njohuri të tilla shkencore a gjeografike. Ajo që tha Kurani i Shenjtë për pengesën mes dy deteve, në të vërtetë, ka një profeci të nënkuptuar, e cila do t'ua shtonte shumë besimin njerëzve të dijes, pasi të përmbushej. Pra, do të vinte një kohë kur ato dete që kishin pengesa të pakapërcyeshme mes njëra-tjetrës, Zoti i Madhërishëm do t'i bënte të bashkoheshin duke ua hequr pengesën. Profeci me këtë temë qartazi përmendet edhe në ajete të tjera të Kuranit të Shenjtë.

Duke cekur përsëri temën e lutjes, e cila vijon prej disa suresh të mëparshme, u tha se kur një hallexhi i lutet Allahut të Madhërishëm, Ai ia plotëson lutjen. Është e çuditshme që edhe kjo temë lidhet me detet, gjë që përmendet në ajete të tjera të Kuranit të Shenjtë. Pra, kur disa njerëz gjenden në ndonjë furtunë në mes të detit pa asnjë rrugëdalje, në këtë gjendje ankthi dhe tejet dëshpëruese, vetëm Zotin e lusin për ndihmë. Atëherë Ai i shpëton nga situata të tilla dhe i sjell te bregu. Por pas këtij shpëtimi, ata të cilët përsëri rikthehen në gjendjen e tyre të mëparshme duke barazuar dikë a diçka tjetër me Zotin, Zoti i Madhërishëm është i Plotfuqishëm t'i fundosë ata që në tokë. Kjo temë shtjellohet gjerësisht në disa ajete të tjera. Kurani i Shenjtë përmend edhe ata të cilët fundosen në tokë të thatë, siç vërejmë fenomene të tilla gjatë tërmetejeve, ku vendbanime të mëdha propozohen në çarjet e tokës për shkak të lëkundjeve të fuqishme.

Në vijim thotë se njeriu duhet t'i thërrasë mendjes për të kuptuar se kush është Ai që e shpëton atë nga çdolloj rreziku nëpër errësirat e tokës dhe të detit. Vallë, a ka Zot tjetër përveç Allahut?! Po kështu, thotë: Kush është Ai që krijon për herë

të parë dhe më pas e përsërit krijimin? Vallë, a ka Zot tjetër përveç Allahut?! Kjo temë duhet t'i japë mësimin njeriut që kur ai sheh se Allahu i Lartësuar bën krijimin e parë (se përndryshe, nuk ka zgjidhje për enigmën se si filloi krijimi), e më pas përditë e përsërit këtë fenomen, pra çdo çast në të gjithë botën falë ujit dalin gjithfarë formash jete nga toka, atëherë i njëjti Zot, si të mos ketë fuqi të plotë për të krijuar njeriun pas vdekjes së tij edhe një herë?! Por ata që nuk kanë njohuri rreth botës tjetër, gjithmonë mbeten në mëdyshje për rilindjen e tyre. Në këtë kontekst, duke iu drejtuar Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, Zoti thotë:

Shembulli i mohuesve dhe i idhujtarëve është si i të vdekurve, të cilëve nuk ua përçon dot zërin tënd. Prandaj, kur ti i thërret drejt udhëzimit, ata që janë të shurdhër nga mendja nuk ta dëgjojnë thirrjen. Po kështu, të verbrit nga shpirti nuk ta shohin dritën. Kjo sepse, ata duhet të kenë dritë edhe në sy që të ndjekin dritën tënde.

Më pas, në ajetin 83, ka një paralajmërim të rëndë për njerëzit që jetojnë si shtazë në tokë, ku thuhet se një gjallesë që ecën po në tokë si ata, është e caktuar t'i ndëshkojë. Të dyja kuptimet e fjalës "*tukel-limuhum*" aplikohen këtu. Kuptimi i parë është që *ajo u flet atyre*. Pra, në kuptimin metaforik, ajo do t'u flasë. Kuptimi i dytë është: *ajo do t'i pickojë ata*, për shkak të së cilës ata do t'i zërë një sëmundje shkatërrimtare. Kështu që, në këtë ajet fjalët "*dābbetul-erdi*" (gjallesë e tokës) u referohen atyre minjve që janë gjallesa të tokës dhe që bëhen shkak të përhapjes së murtajës në tokë. Zakonisht, mikrobi gjendet mbi shpinën e tyre dhe nëpërmjet kontakteve përhapet murtaja.

Në kohën e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, njerëzit mendonin se malet janë të palëvizshme. Por kjo sure, në ajetin 89 të saj, thotë se ato po fluturojnë sikurse retë, në mënyrë të pandërprerë, edhe pse janë të ngulitura fort në tokë. Kjo qartazi do të thotë se së bashku me tokën, po lëvizin edhe malet, edhe retë. Pjesa e fundit e këtij ajeti provon shumë qartë që kjo është krijimtaria e Allahut të Lartësuar, dhe si e tillë, si mund të kritikohet ajo?! Këtu e largoi edhe dyshimin se mbase kjo mund të ndodhte vetëm në Ditën e Kiametit. Jo, sepse Ditën e Kiametit asnjë sy nuk do të ketë fuqi për të parë një ngjarje të tillë ku malet të fluturojnë si retë duke u shkatërruar. Madje, edhe sikur të fluturojnë, do të dalin kundër pohimit të këtij ajeti ku Zoti thotë: "Është mjeshtëria e Allahut që nguliti fort çdo gjë." Për këtë arsye, ky ajet flet pikërisht për lëvizjen e tokës në mënyrë të pandërprerë, e cila po i mbart edhe malet. Kështu, kjo lëvizje e maleve në tokë ngjason me lëvizjen e reve në qiell. Këto tema janë përmendur në Kuranin e Shenjtë, në mënyrë që njerëzit e dijes të fitojnë besimin dhe bindjen që Allahu i Lartësuar, pra Zoti i tyre është Mjeshtri më i Madh.

Në ajetin e fundit të kësaj sureje vjen një premtim, në të cilin thuhet se njerëzit patjetër do t'i dëshmojnë shenjat që janë përmendur në këtë sure, ndër të cilat ka edhe shenja në tokë, por ka edhe shenja qiellore dhe se njerëzit e dijes e të ardhmes do të dëshmojnë duke thënë: Ndodhi pikërisht ashtu siç e kishte parashikuar Kurani i Shenjtë.

1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. *Ta.Sin.* (I Pastër, Gjithëdëgjues.) Këto janë ajete të Kuranit dhe të një Libri të qartë.

طَسَّ ۚ تِلْكَ آيَاتُ الْقُرْآنِ وَكِتَابٍ مُّبِينٍ ①

3. Janë udhëzim dhe lajm i mirë për besimtarët.

هُدًى وَبُشْرَىٰ لِلْمُؤْمِنِينَ ②

4. Ata të cilët kryejnë namazin, japin zekatin dhe me bindje e besojnë *ahiretin*.

الَّذِينَ يُقِيمُونَ الصَّلَاةَ وَيُؤْتُونَ الزَّكَاةَ وَهُمْ بِالْآخِرَةِ هُمْ يُوقِنُونَ ③

5. Ata që nuk besojnë *ahiretin*, Ne ua zbukurojmë punët, andaj, ata vërtiten (në kotësi).

إِنَّ الَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ بِالْآخِرَةِ زَيَّاتًا لَهُمْ أَعْمَالُهُمْ فَهُمْ يَعْمَهُونَ ④

6. Pikërisht këta do të kenë ndëshkim të rëndë, dhe në *ahiret* do të jenë humbësit më të mëdhenj.

أُولَٰئِكَ الَّذِينَ لَهُمْ سُوءُ الْعَذَابِ وَهُمْ فِي الْآخِرَةِ هُمْ الْآخَسَرُونَ ⑤

7. Dhe sigurisht, ti e merr Kuranin prej një të Urti, të Gjithëdijshmi.

وَإِنَّكَ لَتَلْقَى الْقُرْآنَ مِنْ لَدُنْ حَكِيمٍ عَلِيمٍ ⑥

8. (Kujtoje) kur Musai u tha anëtarëve të familjes: “Kam parë një zjarr. Do t’ju sjell ndonjë lajm prej tij, ose do t’ju sjell një urë të ndezur, që të ngrohni ju.”

إِذْ قَالَ مُوسَىٰ لِأَهْلِهِ إِنِّي آنَسْتُ نَارًا ۚ سَاتِيكُمْ مِنْهَا جَبْرَئِيلٌ أَوْ إِيكُمُ بِشَهَابٍ فَبَسَّ لَعَلَّكُمْ تَصْطَلُونَ ⑦

9. E kur iu afrua atij (zjarri), u thirr: “I bekuar është ai që është në këtë zjarr dhe ai që është rreth tij; dhe i Pastër nga çdo e metë është Allahu, Zoti i botëve!

فَلَمَّا جَاءَهَا نُودِيَ أَنْ بُورِكَ مَنْ فِي النَّارِ وَمَنْ حَوْلَهَا ۗ وَسَبِّحَ اللَّهُ رَبَّ الْعَالَمِينَ ⑧

10. O Musa! Jam Unë, Allahu, i Plot-fuqishmi, i Urti.<sup>1</sup>

يُمُوسَى إِنَّهُ أَنَا اللَّهُ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ﴿١٠﴾

11. Hidhe shkopin tënd!” E kur ai e pa atë që po zhdërvillej, sikur të ishte një gjarpër, iku duke treguar shpinën dhe nuk u kthye. “O Musa, mos ki frikë! Të dërguarit nuk frikësohen kur janë pranë Meje.

وَأَلْقِ عَصَاكَ ۖ فَلَمَّا رَأَاهَا تَهْتَزُّ كَأَنَّهَا جَانٌّ وَلَّى مُدْبِرًا ۖ وَلَمْ يُعَقِّبْ ۖ يَمُوسَى لَا تَخَفْ ۖ إِنِّي لَا يَخَافُ لَدَى الْمُرْسَلُونَ ﴿١١﴾

12. Por ai që bëri ndonjë të keqe, dhe pas ligësisë, e ndërroi atë me një të mirë, (për të) sigurisht Unë jam shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

إِلَّا مَنْ ظَلَمَ ثُمَّ بَدَّلَ حُسْنًا بَعْدَ سُوءٍ فَإِنِّي غَفُورٌ رَحِيمٌ ﴿١٢﴾

13. Dhe fute dorën në kraharorin tënd, ajo do të dalë e bardhë pa ndonjë të metë. (Të dyja këto) janë ndër nëntë shenjat (të dërguara) për Faraonin dhe popullin e tij.<sup>2</sup> Pa dyshim, ata janë popull i mosbindur.”

وَأَدْخِلْ يَدَكَ فِي جَيْبِكَ تَخْرُجَ بَيْضًا ۖ مِنْ غَيْرِ سُوءٍ ۗ فِي تِسْعِ آيَاتٍ إِلَىٰ فِرْعَوْنَ وَقَوْمِهِ ۖ إِنَّهُمْ كَانُوا قَوْمًا فَسِيقِينَ ﴿١٣﴾

14. Kur atyre u erdhën shenjat Tona ndriçuese, ata thanë: “Kjo qenka një magji e hapur!”

فَلَمَّا جَاءَهُمْ آيَاتُنَا مُبْصِرَةً قَالُوا هَذَا سِحْرٌ مُّبِينٌ ﴿١٤﴾

1. Ajetet 8 – 10: Këto tri ajete përshkruajnë ngjarjen kur *Hazret Musait*<sup>as</sup> iu zbrit shpallja, gjatë kohës kur ai po udhëtonte së bashku me familjen e tij nga Medjeni për t’u kthyer në Egjipt. Ishin ditë dimri dhe ata kishin nevojë për zjarr. Në malin Tur ai pa një zjarr të ndezur, por kur iu afrua atij, pa që nuk ishte zjarr fizik, por pema në një pjesë të saj ishte jashtëzakonisht e ndriçuar. I erdhi thirrja “I bekuar është ai që është në këtë zjarr dhe ai që është rreth tij”. Allahu është i patrupëzuar. Ai është Zoti i të gjitha botëve. Ky ajete ndër të tjera bën edhe një dallim të hollë duke thënë se u bekuar ai që qe në atë zjarr, si dhe rrethina e tij, dhe kjo me thirrjen e Zotit. Kjo tregon se në atë zjarr ishte ai që u bekuar, dhe jo të ishte i mbyllur Vetë Bekuesi. Bekuesin mund ta gjejmë në nëntekstin e fjalës “u thirr”, sepse Ai e bekoj zjarrin dhe rrethinën e tij. E gjithë kjo tregon se në zjarr nuk ishte personifikuar Zoti. Sipas Kuranit, “*i Pastër nga çdo e metë është Allahu, Zoti i botëve*” (27:9).

2. “*Nëntë shenjat*” ishin: (1) shkopi (2) dora e bardhë (7:108 – 109); (3) shtrëngata që bëri që uji i detit të pushtonte Faraonin dhe ushtritë e tij kur ata po kalonin detin pasi izraelitët e kishin kaluar të sigurt (4) karkalecat (5) morrat (6) bretkosat që nënkuptonin shira të pazakonta e të pandërprera (7) gjaku, d.m.th. një murtajë që shkaktoi gjakderdhje nga hunda (7:134); (8) thatësira dhe (9) humbja e frutave (7:131).

15. I kundërshtuan me mizori dhe rebelim, ndërkohë zemrat e tyre i besonin (shenjzat). Shiko pra, si bëhet fundi i keqbërësve!

وَجَدُوا بِهَا وَاسْتَيْقَنَتْهَا أَنفُسُهُمْ ظُلْمًا  
وَ عُلُوًّا فَأَنْظُرْ كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ  
الْمُفْسِدِينَ ﴿١٥﴾

16. Ne i dhamë dije Davudit dhe Sulejmanit. Ata thanë: “Lavdia është e Allahut që na dha epërsi neve mbi shumë nga robërit e Tij besimtarë.”

وَلَقَدْ آتَيْنَا دَاوُدَ وَسُلَيْمَانَ عِلْمًا وَقَالَا  
الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي فَضَّلَنَا عَلَى كَثِيرٍ مِّنْ  
عِبَادِهِ الْمُؤْمِنِينَ ﴿١٦﴾

17. Davudin e trashëgoi Sulejmani dhe tha: “O njerëz! Neve na është mësuar gjuha e zogjve dhe na është dhuruar diçka nga çdo gjë. Pa dyshim, ky është bekimi i qartë!”

وَوَرِثَ سُلَيْمَانُ دَاوُدَ وَقَالَ يَا أَيُّهَا النَّاسُ  
عَلَّمْنَا مَطْيَقَ الطَّيْرِ وَأَوْتَيْنَا مِنْ كُلِّ  
شَيْءٍ ۗ إِنَّا هَذَا الْفَضْلُ الْمُبِينُ ﴿١٧﴾

18. U mblodhën para Sulejmanit ushtritë e tij prej xhindëve, njerëzve dhe zogjve dhe u rreshtuan në grupe-grupe.

وَ حِشْرَ لَيْسِيمَانَ جُودُهُ مِنَ الْجِنَّ  
وَ الْإِنْسِ وَ الطَّيْرِ فَهُمْ يُورَعُونَ ﴿١٨﴾

19. Kur mbërritën në luginën e Nemlit, një grua (e popullit) Neml tha: “O nemlë! Hyni në shtëpitë tuaja, që të mos ju shkelin nga padija Sulejmani dhe ushtritë e tij!”<sup>3</sup>

حَتَّىٰ إِذَا أَتَوْا عَلَىٰ وَادِ النَّمْلِ قَالَتْ  
نَمْلَةٌ يَا أَيُّهَا النَّمْلُ ادْخُلُوا مَسْكِنَكُمْ ۗ لَا  
يَحْطُمَنَّكُمْ سُلَيْمَانُ وَ جُودُهُ ۗ وَ هُمْ لَا  
يَشْعُرُونَ ﴿١٩﴾

3. *Neml* duke qenë një emër i përveçëm, *Lugina en-Neml* nuk do të thotë lugina e milingonave apo e buburrecave siç keqkuptohet përgjithësisht, por lugina ku jetonte një fis i quajtur *neml*. Në fjalor është e shkruar: “*Abraka është një prej burimeve të Nemles.*” (El-Kamusul-Muhit, zëri برفى 866). Pra, *neml* ishte emri i një fisi dhe emërtime të tilla në vendet arabe nuk janë gjëra të jashtëzakonshme. *Benu Esed, Benu Kelb* etj., që nëse përkthehen fjalë për fjalë do të ishin “bijtë e luanit”, “bijtë e qenit” etj., dhe plot emra të tjerë si këta, janë dëshmitarë të këtij fakti. Përveç kësaj, folja urdhërore, si dhe përemri vetor që të dyja në gjininë mashkullore që janë përdorur në fjalët e këtij ajeti “*udkhalū mesākinekum*” (*hyni në shtëpitë tuaja*), në arabisht përdoren për njerëzit dhe jo për kafshët (29:39; 32:27). Kështu, *nemle* do të thotë një anëtar/e i fisit en-neml, që ndoshta kishte tagrin e një prijësi, dhe për këtë arsye u thoshte banorëve të tjerë të hynin në banesa dhe të mos dilnin para ushtrisë së *Hazret Sulejmanit*<sup>as</sup>. Sipas fjalorit, “*Lugina En-Neml gjendet midis Xhibrinin dhe Askalanit.*” (Taxh el-Arus, zëri ودى f. 185). Dhe librat e gjeografisë për Askalanin dhe Xhibrinin pohojnë: Askalani është një prej qyteteve më të mëdha bregdetare, i cili ndodhet 12 milje në drejtim të veriut nga Gazza, e cila është një

20. Atëherë (Sulejmani) qeshi nga fjala e saj dhe tha: “O Zoti im! Më mundëso të të falënderoj për bekimin që më dhe mua dhe prindërve të mi; të bëj të mirat që Ti i pëlqen, dhe me mëshirën Tënde më prano në grupin e robërve të Tu të sinqertë.”

فَتَبَسَّ صَاحِبًا مِّنْ قَوْلِهَا وَقَالَ رَبِّ  
أَوْزِعْنِي أَنْ أَشْكُرَ نِعْمَتَكَ الَّتِي  
أَنْعَمْتَ عَلَيَّ وَعَلَىٰ وَالِدَيَّ وَأَنْ أَعْمَلَ  
صَالِحًا تَرْضَاهُ وَأَدْخِلْنِي بِرَحْمَتِكَ فِي  
عِبَادِكَ الصَّالِحِينَ ﴿٢٠﴾

21. I inspektoi zogjtë dhe tha: “Çfarë kam që nuk po e shoh Hud-hudin,<sup>4</sup> apo ka munguar ai?

وَتَفَقَّدَ الطَّيْرَ فَقَالَ مَا لِيَ لَا أَرَى  
الْهُدُودَ ۗ أَمْ كَانَ مِنَ الْغَائِبِينَ ﴿٢١﴾

22. Do ta ndëshkoj rëndë ose do ta ther, ose ai duhet të më vijë me ndonjë argument të qartë!”

لَا عَذَابَ لَهُ عَذَابًا شَدِيدًا أَوْ لَأَذْبَحَهُ أَوْ  
لِيَأْتِيَنِي بِسُلْطَنٍ مُّبِينٍ ﴿٢٢﴾

23. Atëherë (Sulejmani) nuk priti gjatë që (erdhi Hud-hudi) dhe tha: “Kam arritur të di diçka që ti nuk e ke ditur dhe kam ardhur nga Saba me një lajm të besueshëm.”<sup>5</sup>

فَمَكَثَ غَيْرَ بَعِيدٍ فَقَالَ أَحَطُّ بِمَا لَمْ  
تُحِطْ بِهِ وَجِئْتُكَ مِنْ سَبَأٍ بِنَبَأٍ يَقِينٍ ﴿٢٣﴾

24. Kam gjetur që një grua po i sundon ata; asaj i është dhënë diçka nga çdo gjë dhe ajo ka një fron madhështor.

إِنِّي وَجَدْتُ امْرَأَةً تَمْلِكُهُمْ وَأُوتِيَتْ  
مِنْ كُلِّ شَيْءٍ وَلَهَا عَرْشٌ عَظِيمٌ ﴿٢٤﴾

port detar i Palestinës, ngjitur me Sinain. Kurse Xhibrini është qytet verior në Prefekturën e Damaskut.’ (Takvimul-Buldan f. 238-239; Mu’xhemul-Buldan, vëll. 6, f. 174)

Kështu që, Lugina e Nemlit bie afër Jerusalemit, dhe që ndodhet në rrugën nga Damasku në Hixhaz, përafërsisht 150 kilometra poshtë Damaskut. Në këto zona, deri në kohën e *Hazret Sulejmanit*<sup>as</sup>, jetonin shumë fise arabe dhe medjane.

Ky ajet gjithashtu tregon se ushtria e *Hazret Sulejmanit* nuk i dëmtonte ata që nuk e sulmonin, as ata që ishin të dobët.

4. *Hud-hud* duket se është forma e arabizuar e emrit Hadad, emër që është i njohur në Bibël. Mund të jetë një prej gjeneralëve të ushtrisë së *Hazret Sulejmanit*<sup>as</sup>.

5. Nga ky ajet duket se Hud-hudi u dërgua për një mision të rëndësishëm shtetëror dhe ai solli për *Hazret Sulejmanin*<sup>as</sup> një lajm të rëndësishëm. Saba mund të identifikohet me mbretëreshën e Shebës që përmendet në Bibël (Bibla, 1 i Mbretërve, kap. 10). Sheba ishte një qytet në Jemen, i vendosur rreth tri ditë rrugë nga qyteti Sanaa dhe ishte kryeqendra e qeverisë së Mbretëreshës së Shebës.

25. Atë dhe popullin e saj i gjeta që po adhuronin diellin duke e lënë Allahun dhe djalli ua zbukuroi punët, pra, ai i pengoi ata nga rruga (e drejtë) dhe kështu ata nuk udhëzohen.

26. (Djalli i nxiti ata që) të mos i bëjnë sexhde Allahut, i cili nxjerr thesaret e fshehta nga qiejt dhe toka, gjithashtu di edhe atë që fshihni si dhe atë që shfaqni.

27. Allahu; nuk ka të adhureshëm tjetër përveç Atij, Zotit të Arshit të Madhërishtëm.”

Sexhdeja IX

28. (Sulejmani) tha: “Do të shohim nëse e the të vërtetën apo je një gënjeshtar.

29. Merr këtë letër timen, dorëzovua atyre e mënjanohu prej tyre dhe, më pas, shih se çfarë përgjigje do të kthejnë.”

30. (Duke e marrë letrën, mbretëresha) tha: “O oborrtarë! Mua më erdhi një letër e nderuar;

31. Ajo është prej Sulejmanit dhe është: “Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit;

32. (Mesazhi i tij është): Mos u rebeloni kundër meje dhe ejani tek unë të nënshtruar!”

33. Ajo tha: “O oborrtarë! Më këshilloni në çështjen time. Unë nuk vendos ndonjë çështje, veçse kur ju jeni të pranishëm.”

وَجَدْتَهَا وَقَوْمَهَا يَسْجُدُونَ لِلشَّمْسِ مِنْ  
دُونِ اللَّهِ وَزَيْنَ لَهُمُ الشَّيْطَانُ أَعْمَالَهُمْ  
فَصَدَّهُمْ عَنِ السَّبِيلِ فَهُمْ لَا يَهْتَدُونَ ﴿١٥﴾

أَلَّا يَسْجُدُوا لِلَّهِ الَّذِي يُخْرِجُ الْخَبَاءَ فِي  
السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَيَعْلَمُ مَا تُخْفُونَ وَمَا  
تُعْلِنُونَ ﴿١٦﴾

اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ رَبُّ الْعَرْشِ  
الْعَظِيمِ ﴿١٧﴾

قَالَ سَنَنْظُرُ أَصَدَقْتَ أَمْ كُنْتَ مِنَ  
الْكَذِبِينَ ﴿١٨﴾

إِذْ هَبْ بِيكُنُيْ هَذَا فَالِقَهُ إِلَيْهِمْ ثُمَّ  
تَوَلَّى عَنْهُمْ فَانظُرْ مَاذَا يَرْجِعُونَ ﴿١٩﴾

قَالَتْ يَا أَيُّهَا الْمَلَأُوْا إِنِّي أُنصِي إِلَيْكُمْ  
كِرِيمٌ ﴿٢٠﴾

إِنَّهُ مِنْ سُلَيْمَانَ وَإِنَّهُ بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ  
الرَّحِيمِ ﴿٢١﴾

أَلَّا تَعْلَمُوا عَلَيَّ وَأَتُونِي مُسْلِمِينَ ﴿٢٢﴾

قَالَتْ يَا أَيُّهَا الْمَلَأُوْا أَفْتُونِي فِي أَمْرِي  
مَا كُنْتُ قَاطِعَةً أَمْرًا حَتَّى تَشْهَدُونِ ﴿٢٣﴾



34. Ata thanë: “Ne jemi të fuqishëm dhe luftëtarë shumë të fortë, por vendimi të takon ty. Shikoje vetë se çfarë do të (na) urdhërosh.”

قَالُوا نَحْنُ أَوْلُوا قُوَّةً وَأَوْلُوا بِأَسْـَٔدٍ  
وَالْأَمْرُ إِلَيْكَ فَانْظُرِي مَاذَا تَأْمُرِينَ ﴿٣٤﴾

35. Ajo tha: “Mbretërit kur hyjnë në një vendbanim, e shkatërrojnë, dhe banorët e nderuar të tij i poshtërojnë. E kështu veprojnë ata.

قَالَتْ إِنَّ الْمُلُوكَ إِذَا دَخَلُوا قَرْيَةً  
أَفْسَدُوهَا وَجَعَلُوا أَعْرَآةَ أَهْلِهَا آذِلَّةً  
وَكَذَلِكَ يَفْعَلُونَ ﴿٣٥﴾

36. Unë do t’u dërgoj një dhuratë, e do të shoh se me çfarë (përgjigje) kthehen lajmëtarët.”

وَإِنِّي مُرْسِلَةٌ إِلَيْهِمْ بِهَدِيَّةٍ فَرْحَةً  
بِمَا يَرْجِعُ الْمُرْسَلُونَ ﴿٣٦﴾

37. Kur (delegacioni) erdhi te Sulejmani, (Sulejmani) tha: “A mua do të më ndihmoni me para?! Atë që ma dha Allahu, është më e mirë sesa ajo që keni sjellë ju. Madje, ju po mburreni me dhuratën tuaj!

فَلَمَّا جَاءَ سُلَيْمَنَ قَالَ أُمِدُّونَ بِمَالٍ  
فَمَا آتَىٰ اللَّهُ خَيْرٌ مِّمَّا أَتَيْتُمْ ۖ بَلْ أَنْتُمْ  
بِهَدِيَّتِكُمْ تَفْرَحُونَ ﴿٣٧﴾

38. Kthehu te ta! Ne përnjëmend do të vijmë te ta me një ushtri, së cilës ata nuk do t’i bëjnë dot ballë, dhe do t’i përzëmë prej atij (vendbanimi në gjendje) të poshtëruar dhe ata do të jenë të mundur.”

ارْجِعْ إِلَيْهِمْ فَلَنَأْتِيَنَّهُمْ بِجُنُودٍ لَا قِبَلَ  
لَهُمْ بِهَا وَلَنُخْرِجَنَّهُمْ مِنْهَا آذِلَّةً وَهُمْ  
صَاغِرُونَ ﴿٣٨﴾

39. (Sulejmani) tha: “O oborrtarë! Cili prej jush mund të më sjellë fronin e saj, përpara se ata të më vijnë të nënshtuar?”

قَالَ يَا أَيُّهَا الْمَلَأُوا أَيُّكُمْ يَأْتِينِي بِعَرْشِهَا  
قَبْلَ أَنْ يَأْتُونِي مُسْلِمِينَ ﴿٣٩﴾

40. Ifriti<sup>6</sup> prej xhindëve tha: “Unë do të ta sjell atë, përpara se të çohesh nga vendi yt dhe pa dyshim, për këtë (punë) jam i fuqishëm (dhe) i besueshëm.”

قَالَ عَفْرَيْتُ مِنَ الْجِنِّ أَنَا آتِيكَ بِهِ قَبْلَ  
أَنْ تَقُومَ مِنْ مَقَامِكَ ۖ وَإِنِّي عَلَيْهِ لَقَوِيٌّ  
أَمِينٌ ﴿٤٠﴾

6. *Ifriti* që u përmend se ishte prej xhindëve, nuk është ai xhind që përfytyrohet nga njerëzit si një krijesë e mbinatyrshme. Xhind i thoshin edhe prijësit të një populli malësor dhe njerëzit e tillë i ishin nënshtuar *Hazret Sulejmanit*<sup>65</sup>.

41. Ai që ishte pranë tij (dhe që) kishte dijen e librit,<sup>7</sup> tha: “Unë do të ta sjell atë përpara se të kthesh shikimin tënd.”<sup>8</sup> Dhe kur (Sulejmani) e pa atë (fron) të vendosur përpara tij, tha: “Kjo është prej bekimit të Zotit tim, që Ai të më sprovtojë nëse falënderoj apo bëhem mosmirënjohës; dhe ai që falënderon, falënderon për veten e vet, kurse ai që bëhet mosmirënjohës, (ta dijë se) Zoti im është i Pavarur, i Nderuar.”

قَالَ الَّذِي عِنْدَهُ عِلْمٌ مِّنَ الْكِتَابِ أَنَا  
أَتَيْكَ بِهِ قَبْلَ أَنْ يَرْتَدَّ إِلَيْكَ طَرْفُكَ ۗ  
فَلَمَّا رَأَاهُ مُسْتَقَرًّا عِنْدَهُ قَالَ هَذَا مِنْ  
فَضْلِ رَبِّي ۗ لِيَبْلُوَنِي ۚ أَشْكُرُ أَمْ أَكْفُرُ ۗ  
وَمَنْ شَكَرَ فَإِنَّمَا يَشْكُرُ لِنَفْسِهِ ۗ وَمَنْ  
كَفَرَ فَإِنَّ رَبِّي غَنِيٌّ كَرِيمٌ ﴿٧﴾

42. Ai tha: “Bëjeni që froni i saj të mos i duket i veçantë, të shohim nëse zbulon të vërtetën, apo nuk e zbulon të vërtetën.”<sup>9</sup>

قَالَ نَكِّرُوا لَهَا عَرْشَهَا نَنْظُرَ أَتَهْتَدِي  
أَمْ تَكُونُ مِنَ الَّذِينَ لَا يَهْتَدُونَ ﴿٨﴾

43. E kur ajo erdhi, u pyet: “A është kështu froni yt?” Tha: “Sikur ai është! Ne kemi marrë dijen përpara kësaj dhe tanimë jemi të nënshtruar.”

فَلَمَّا جَاءَتْ قِيلَ أَهَكَذَا عَرْشُكَ ۗ  
قَالَتْ كَأَنَّهُ هُوَ ۗ وَأُوتِينَا الْعِلْمَ مِنْ  
قَبْلِهَا وَكُنَّا مُسْلِمِينَ ﴿٩﴾

7. Fjalët “*dija e librit*” nuk nënkuptojnë dijen e Teuratit, por dijen e shkencës, siç e tha edhe Profeti Muhammed<sup>savs</sup> se dija është e dylojshme: dija e besimeve dhe dija e materies (Bihar el-Envar, nr. 52). Se përndryshe, aty kush mund të kishte dijen e Teuratit më shumë sesa vetë Hazret Sulejmani<sup>as</sup>, pasi ai ishte Profet i Zotit?! Ky ajet është shembull i dijes së materies dhe njeriu që i flet Hazret Sulejmanit në këtë ajet duket se ishte mjeshtër i shkencës së arkitekturës dhe që arrinte të ndërtonte një fron identik me fronin e mbretëreshës, mu para syve të Hazret Sulejmanit<sup>as</sup>.

8. Fjalët “*përpara se të kthesh shikimin tënd*” është shprehje që përdoret thuasje në çdo gjuhë. Pra, do të thotë se një mjeshtër i dijes pretendoi ta realizonte ndërtimin e fronit përpara syve të Hazret Sulejmanit<sup>as</sup>. Veç kësaj, fjala *taf* që përkthehet *shikim* ka edhe një kuptim tjetër: *çetë mbrojtëse*. Duke iu referuar këtij kuptimi të dytë, ajeti mund të përkthehet si vijon: *Unë do të ta sjell atë përpara se të kthehet çeta jote mbrojtëse*.

9. Ky ajet ka kuptimin që Hazret Sulejmani<sup>as</sup> porositi që fronin, për të cilin mbretëresha mburrej, ta bënin si diçka të rëndomtë dhe jo ta sillnin fronin e saj e më pas ta tjetëronin atë, sepse ajetet në vijim tregojnë se tjetërsimi i fronit nuk qe qëllimi, pasi mbretëresha nuk pohoi se ishte i ndryshuar.

44. Dhe (Sulejmani) e ndaloi atë nga ajo çka adhuronte ajo përveç Allahut. Pa dyshim, ajo ishte nga një popull mohues.

وَصَدَّهَا مَا كَانَتْ تُعْبُدُ مِنْ دُونِ اللَّهِ  
إِنَّهَا كَانَتْ مِنْ قَوْمٍ كَافِرِينَ ﴿٤٤﴾

45. Asaj i thanë: “Hyr në pallat!” E kur ajo e pa, mendoi se ishte ujë dhe ngriti rrobat te këmbët. (Sulejmani) tha: “Në të vërtetë, ky pallat është i shtruar me xhama.” Ajo tha: “O Zoti im! I kam bërë keq vetes dhe (tani), bashkë me Sulejmanin, i nënshtrohem Allahut, Zotit të botëve.”<sup>10</sup>

قِيلَ لَهَا ادْخُلِي الصَّرْحَ فَلَمَّا رَأَتْهُ  
حَسِبَتْهُ لُجَّةً وَكَشَفَتْ عَنْ سَاقَيْهَا قَالَ  
إِنَّهُ صَرْحٌ مُّمَرَّدٌ مِنْ قَوَارِيرَ قَالَتْ  
رَبِّ إِنِّي ظَلَمْتُ نَفْسِي وَأَسْلَمْتُ مَعَ  
سُلَيْمَانَ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿٤٥﴾

46. Ne i dërguam popullit Themud vëllain e tyre, Salihun (duke thënë): “Adhuroni Allahun!” Dhe ja që ata u bënë dy grupe që grinden.

وَلَقَدْ أَرْسَلْنَا إِلَى ثَمُودَ أَخَاهُمْ صَالِحًا  
أَنِ اعْبُدُوا اللَّهَ فَإِذَا هُمْ فَرِيقَيْنِ  
يَخْتَصِمُونَ ﴿٤٦﴾

10. Kur mbretëresha e Sabasë hyri në pallat, dyshemeja e së cilës ishte veshur me xhama të pastër, ajo mendoi se ishte ujë. Për të mos u lagur, i përvoli rrobat te këmbët. Atëherë Hazret Sulejmani<sup>as</sup> i tregoi se pallati ishte i shtruar me xhama, dhe ashtu siç ajo gaboi duke e pandehur dyshemenë për ujë, në të njëjtën mënyrë, gaboi duke e marrë diellin për Zot, sepse burimi i dritës së diellit është fuqia e Zotit dhe jo vetë dielli. Me këtë përpjekje të tij, ajo e kuptoi gabimin se ajo dhe populli i saj adhuronin diçka që nuk e ka fuqinë prej vetes, por të dhuruar prej Zotit, siç aty nuk qe ujë, por uji rridhte përtej xhamave. Realisht, dashuria e njeriut ndaj pasurisë, fëmijëve, bashkëshortes, ose edhe tërheqja e tij ndaj tingujve të një zëri të bukur janë pikërisht kërkimi i tij për të Dashurin e humbur. Ngaqë njeriu nuk e sheh dot me sytë fizikë atë Qenie që fshihet pas shumë perdesh dhe që gjendet e fshehur si shkëndijë në çdo gjë, e as nuk e percepton dot qoftë me gjithë mendjen e tij, andaj, ai ka bërë gabime të mëdha në njohjen e Tij, madje, të drejtën që i takonte Atij, ua ka dhënë të tjerëve. Ky ajet tregon se bota është si një ngrehinë prej qelqi që ka dysheme të shtruar me xhama shumë të pastër e të tejdukshëm, nën të cilët rrjedh ujë fuqishëm. Çdokush që do ta shohë, dyshemenë dhe xhamat do t'i pandehë për ujë dhe druhet të vërë këmbën duke kujtuar se do të bjerë në të. Por do të jenë vetëm qelqe të tejdukshme. Në të njëjtën mënyrë, edhe trupat e mëdha qjellore që shohim, siç është dielli, hëna etj., janë po ato qelqe të tejdukshme, të cilat janë adhuroar pa të drejtë dhe nën të cilat vepron një fuqi më e lartë, që rrjedh fuqimisht anembanë. Por, adhuresit e krijesave gabimisht qelqeve u japin meritën, e cila i takon fuqisë së nëntëshme.

47. Ai tha: “O populli im! Pse nxitoheni për të keqen përpara së mirës?! Pse nuk i kërkoni falje Allahut, që të mëshiroheni?!”

48. Ata thanë: “Kemi ogur të keq prej teje dhe prej atyre që janë me ty.” (Salihu) tha: “Oguri juaj është tek Allahu, madje jeni një popull në sprovë.”

49. Dhe në qytet ishin nëntë veta, që bënin ngatërresa në tokë dhe nuk bënin përmirësime.

50. Thanë: “Të betohemi në Allah përpara njëri-tjetrit që do ta sulmojmë atë dhe familjen e tij gjatë natës e më pas do t’i themi të zotit të tij “nuk e pamë shkatërrimin e familjes së tij dhe ne sigurisht që po themi të vërtetën!””.

51. Ata bënë strategji, edhe Ne bëmë strategji, por ata nuk e kuptuan.

52. Shiko, pra, si qe fundi i strategjisë së tyre: Ne i shkatërruam ata dhe krejt popullin e tyre.

53. Ja ku janë shtëpitë e tyre, të shkretuara për shkak të keqbërjes së tyre. Sigurisht, në të ka një shenjë për njerëzit që dinë.

54. Dhe shpëtuan ata që besuan dhe që patën druajtje (ndaj Nesh).

قَالَ يَوْمَ لِمَ تَسْعَجُونَ بِلَيْسِيَّةِ قَبْلِ  
الْحَسَنَةِ ۗ لَوْلَا تَسْتَغْفِرُونَ اللَّهَ لَعَلَّكُمْ  
تُرْحَمُونَ ﴿٤٧﴾

قَالُوا اطَّيَّرْنَا بِكَ وَبِمَنْ مَعَكَ ۗ قَالَ  
طَيَّرَكُمْ عِنْدَ اللَّهِ بَلْ أَنْتُمْ قَوْمٌ  
تُفْتَنُونَ ﴿٤٨﴾

وَكَانَ فِي الْمَدِينَةِ تِسْعَةُ رَهْطٍ يُفْسِدُونَ  
فِي الْأَرْضِ وَلَا يُصْلِحُونَ ﴿٤٩﴾

قَالُوا تَفَاسَمُوا بِاللَّهِ لَنُبَيِّتَنَّهُ وَأَهْلَهُ ثُمَّ  
لَنَقُولَنَّ لَوْ لِيهِ مَا شَهِدْنَا مَهْلِكَ أَهْلِهِ  
وَإِنَّا لَصَادِقُونَ ﴿٥٠﴾

وَمَكَرُوا وَمَكَرَوا مَكْرًا وَمَكَرْنَا مَكْرًا وَهُمْ  
لَا يُشْعُرُونَ ﴿٥١﴾

فَانظُرْ كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ مَكْرِهِمْ ۗ أَنَا  
دَمَرْتُهُمْ وَقَوْمُهُمْ أَجْمَعِينَ ﴿٥٢﴾

فَتِلْكَ بُيُوتُهُمْ خَاوِيَةً بِمَا ظَلَمُوا ۗ إِنَّ فِي  
ذَلِكَ لَآيَةً لِّقَوْمٍ يَعْلَمُونَ ﴿٥٣﴾

وَأَنْجَيْنَا الَّذِينَ آمَنُوا وَكَانُوا يَتَّقُونَ ﴿٥٤﴾

55. (Shpëtuam) edhe Lutin, kur ai i tha popullit të tij: “A po bëni paturpësinë edhe pasi e kuptoni (se çfarë jeni duke bërë)?!”

56. A shkoni te meshkujt për epsh në vend të grave? Qenkeni një popull injorant!”

57. Atëherë çfarë përgjigje kishte populli i tij përveçse të thoshin: “Përzëreni familjen e Lutit nga fshati juaj; qenkan njerëz “të pastër”!”

58. Ne e shpëtuam atë dhe familjen e tij, përveç gruas së tij, të cilën e llogaritëm ndër ata që qëndruan mbrapa.

59. Lëshuam një shi mbi ta. Eh sa i rëndë është shiu që u bie të paralajmëruarve!

60. Thuaj: Lavdia është e Allahut dhe paqja qoftë mbi robërit e Tij që Ai zgjodhi. A është më i miri Allahu apo ato që ata i bëjnë ortakë me Të?!

Xhuzi 20

61. Ose, (më thoni) kush është ai që krijoi qiejt dhe tokën dhe prej qiellit zbriti ujë për ju?! Pastaj, nëpërmjet tij Ne krijuam kopshte të mrekullueshme. Ju nuk kishit fuqi të lulëzonit pemët e tyre. A ka ndonjë të adhureshëm tjetër përveç Allahut?! Përkundrazi, ata janë popull i padrejtë.

وَلَوْطًا إِذْ قَالَ لِقَوْمِهِ أَتَأْتُونَ الْفَاحِشَةَ  
وَأَنْتُمْ تَبْصُرُونَ ﴿٢٥﴾

أَيُّكُمْ لَتَأْتُونَ الرِّجَالَ شَهْوَةً مِنْ دُونِ  
النِّسَاءِ ۗ بَلْ أَنْتُمْ قَوْمٌ تَجْهَلُونَ ﴿٢٦﴾

فَمَا كَانَ جَوَابَ قَوْمِهِ إِلَّا أَنْ قَالُوا  
أَخْرِجُوا آلَ لُوطٍ مِنْ قَرْيَتِكُمْ ۚ إِنَّهُمْ  
أُنَاسٌ يَتَطَهَّرُونَ ﴿٢٧﴾

فَأَنْجَيْنَاهُ وَأَهْلَهُ إِلَّا امْرَأَتَهُ ۗ قَدَّرْنَا  
مِنْ الْغَابِرِينَ ﴿٢٨﴾

وَأَمْطَرْنَا عَلَيْهِمْ مَطَرًا ۖ فَسَاءَ مَطَرُ  
الْمُنذَرِينَ ﴿٢٩﴾

قُلِ الْحَمْدُ لِلَّهِ وَسَلَامٌ عَلَى عِبَادِهِ الَّذِينَ  
أَصْطَفَى ۗ اللَّهُ خَيْرٌ مِمَّا يَشْرِكُونَ ﴿٣٠﴾

الَّذِينَ آمَنُوا مِنْ خَلْقِ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَأَنْزَلَ  
لَكُمْ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً ۖ فَأَنْبَتْنَا بِهِ حَدَائِقَ  
ذَاتِ بَهْجَةٍ ۚ مَا كَانَ لَكُمْ أَنْ تُشْبَهُوا  
شَجَرَهَا ۗ إِنَّ اللَّهَ مَعَ الَّذِينَ هُمْ قَوْمٌ  
يَعْدِلُونَ ﴿٣١﴾

62. Ose, kush është ai që bëri tokën si vendpushim, krijoi lumenj mes saj, bëri male në të dhe vuri një pengesë midis dy deteve?! A ka ndonjë të adhureshëm tjetër përveç Allahut?! Përkundrazi, shumica prej tyre nuk dinë.

63. Ose, kush është ai që i përgjigjet lutjes së hallexhiut, kur ai i lutet Atij dhe ia largon (edhe) shqetësimin, dhe ju bën pasardhës të tokës?! A ka ndonjë të adhureshëm tjetër përveç Allahut?! Sa pak reflektoni!

64. Ose, kush është ai që ju udhëzon në errësirat e tokës e të detit dhe kush është ai që dërgon erërat si sihariq përpara mëshirës së tij?! A ka ndonjë të adhureshëm tjetër përveç Allahut?! Shumë i lartë është Allahu nga gjithçka që ata e bëjnë ortakë me Të.

65. Ose, kush është ai që nis krijimin e më pas e përsërit atë? Dhe kush është ai që ju ushqen prej qiellit dhe tokës?! A ka ndonjë të adhureshëm tjetër përveç Allahut?! Thuaju: Sillni argumentin tuaj, nëse jeni të vërtetë.

66. Thuaj: Askush në qiej e tokë nuk e di të padukshmen, përveç Allahut. Ata nuk dinë se kur do të ngrihen (pas ringjalljes).

67. Madje, u ka sosur dija rreth *ahiretit*, madje, janë në dyshim rreth tij; madje, janë të verbër ndaj tij.

أَمْ مَنْ جَعَلَ الْأَرْضَ قَرَارًا وَ جَعَلَ خِلْفَهَا  
أَنْهَرًا وَ جَعَلَ لَهَا رَوَاسِيَ وَ جَعَلَ بَيْنَ  
الْبَحْرَيْنِ حَاجِزًا ؕ ءِإِلَٰهَ مَعَ اللَّهِ  
بَلْ أَكْثَرُهُمْ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٦٢﴾

أَمْ مَنْ يُجِيبُ الْمُضْطَرَّ إِذَا دَعَاهُ  
وَ يَكْشِفُ السُّوءَ وَ يَجْعَلُكُمْ خُلَفَاءَ  
الْأَرْضِ ؕ ءِإِلَٰهَ مَعَ اللَّهِ ؕ قَلِيلًا مَّا  
تَذَكَّرُونَ ﴿٦٣﴾

أَمْ مَنْ يَهْدِيكُمْ فِي ظُلُمَاتِ الْبَرِّ وَالْبَحْرِ  
وَ مَنْ يُرْسِلُ الرِّيْحَ بُشْرًا بَيْنَ يَدَيْ  
رَحْمَتِهِ ؕ ءِإِلَٰهَ مَعَ اللَّهِ ؕ تَعَلَى اللَّهُ عَمَّا  
يُشْرِكُونَ ﴿٦٤﴾

أَمْ مَنْ يَبْدُوا الْخَلْقَ ثُمَّ يُعِيدُهُ وَ مَنْ  
يَرْزُقُكُمْ مِنَ السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ ؕ ءِإِلَٰهَ مَعَ  
اللَّهِ ؕ قُلْ هَاتُوا بُرْهَانَكُمْ إِنْ كُنْتُمْ  
صَادِقِينَ ﴿٦٥﴾

قُلْ لَا يَعْلَمُ مَنْ فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ  
الْغَيْبَ إِلَّا اللَّهُ ؕ وَ مَا يَشْعُرُونَ أَيَّانَ  
يُبْعَثُونَ ﴿٦٦﴾

بَلْ ادْرِكْ عِلْمَهُمْ فِي الْآخِرَةِ ۚ بَلْ هُمْ فِي  
شَكٍّ مِمَّا بَلَّغْتُمْ مِنْهَا عَمُونَ ﴿٦٧﴾

68. Ata që mohuan thanë: “Ne dhe baballarët tanë kur do të bëhemi dhe, vallë, a do të nxirremi sërish!

69. E po kështu na premtuan neve e baballarëve tanë më përpara. Këto janë vetëm përrallat e të parëve.”

70. Thuaju: Udhëtoni në tokë që të shikoni se si qe fundi i fajtorëve.

71. Ti mos u brengos për ta dhe as mos u ngushto për kurthet e tyre.

72. Ata thonë: “Kur do të plotësohet ky premtim, nëse jeni të vërtetë?”

73. Thuaj: Ka mundësi që disa prej atyre që ju i kërkoni me nxitim, janë pas jush.

74. Zoti yt, pa dyshim, bën mirësi të madhe ndaj njerëzve, por shumica e tyre nuk falënderojnë.

75. Dhe Zoti yt e di shumë mirë edhe atë që fshehin kraharorët e tyre, edhe atë që shfaqin.

76. Nuk ka asnjë të fshehtë as në qiell e as në tokë, që të mos jetë (e shënuar) në një Libër të qartë.

77. Sigurisht, ky Kuran u tregon bijve të Izraelit shumicën e atyre gjërave të cilat ata kundërshtojnë.<sup>11</sup>

وَقَالَ الَّذِينَ كَفَرُوا إِذَا كُنَّا تُرَابًا  
وَأَبَاؤُنَا إِنَّا لَمُخْرَجُونَ ﴿١٨﴾

لَقَدْ وَعَدْنَا هَذَا نَحْنُ وَآبَاؤُنَا مِنْ قَبْلُ  
إِنْ هَذَا إِلَّا آسَاطِيرُ الْأَوَّلِينَ ﴿١٩﴾

قُلْ سِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَانظُرُوا كَيْفَ  
كَانَ عَاقِبَةُ الْمُجْرِمِينَ ﴿٢٠﴾

وَلَا تَحْزَنْ عَلَيْهِمْ وَلَا تَكُنْ فِي ضَيْقٍ  
مِّمَّا يَمْكُرُونَ ﴿٢١﴾

وَيَقُولُونَ مَتَى هَذَا الْوَعْدُ إِنْ كُنْتُمْ  
صَادِقِينَ ﴿٢٢﴾

قُلْ عَسَى أَنْ يَكُونَ رَدِفَ لَكُمْ بَعْضُ  
الَّذِي تَسْتَعْجِلُونَ ﴿٢٣﴾

وَإِنَّ رَبَّكَ لَذُو فَضْلٍ عَلَى النَّاسِ وَلَكِنَّ  
أَكْثَرَهُمْ لَا يَشْكُرُونَ ﴿٢٤﴾

وَإِنَّ رَبَّكَ لَيَعْلَمُ مَا تُكِنُّ صُدُورُهُمْ  
وَمَا يُعْلِنُونَ ﴿٢٥﴾

وَمَا مِنْ غَابِطَةٍ فِي السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ إِلَّا  
فِي كِتَابٍ مُبِينٍ ﴿٢٦﴾

إِنَّ هَذَا الْقُرْآنَ يُقْصُّ عَلَى بَنِي إِسْرَائِيلَ  
أَكْثَرَ الَّذِي هُمْ فِيهِ يَحْتَلِمُونَ ﴿٢٧﴾

11. Bibla tregon mite e tregime të çuditshme për temat që janë përmendur në ajetet e mësipërme të kësaj sureje. Kurani i Shenjtë solli faktet, tregoi të vërtetën e atyre ndodhive dhe hodhi

78. Dhe, pa dyshim, ky (Kuran) është udhëzim dhe mëshirë për besimtarët.

وَإِنَّهُ لَهْدَىٰ وَرَحْمَةً لِّلْمُؤْمِنِينَ ﴿٧٨﴾

79. Zoti yt do të vendosë mes tyre me urtësinë e Tij dhe Ai është i Plotfuqishmi, i Gjithëdijshti.

إِنَّ رَبَّكَ يَفْضِي بَيْنَهُمْ بِحُكْمِهِ ۗ وَهُوَ الْعَزِيزُ الْعَلِيمُ ﴿٧٩﴾

80. Prandaj, mbështetu tek Allahu. Sigurisht, ti qëndron mbi të vërtetën e qartë.

فَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ ۗ إِنَّكَ عَلَى الْحَقِّ الْمُبِينِ ﴿٨٠﴾

81. Ti nuk mund t'i bësh të vdekurit të dëgjojnë dhe as të shurdhrit të dëgjojnë thirrjen, kur ata largohen duke e kthyer shpinën.

إِنَّكَ لَا تَسْمَعُ الْمَوْتَىٰ وَلَا تَسْمَعُ الصُّمَّ الدُّعَاءَ إِذَا وَلَّوْا مُدْبِرِينَ ﴿٨١﴾

82. Dhe as nuk mund të udhëzosh të verbrit duke i nxjerrë ata nga devijimi i tyre. Ti mund të bësh të dëgjojnë vetëm ata që besojnë në shenjat Tona, dhe ata janë të nënshtruar.

وَمَا أَنْتَ بِهَدِي الْعُصَىٰ عَن صَلَاتِهِمْ ۗ إِنَّ تَسْمَعُ إِلَّا مَن يُوْمِنُ بِآيَاتِنَا فَهُمْ مُّسْلِمُونَ ﴿٨٢﴾

83. Dhe kur do të plotësohet fjala kundër tyre,<sup>12</sup> Ne do të nxjerrim për ta një gjallesë nga toka, që do t'i pickojë ata (për arsye) se njerëzit nuk besojnë në shenjat Tona.<sup>13</sup>

وَإِذَا وَقَعَ الْقَوْلُ عَلَيْهِمْ أَخْرَجْنَا لَهُمْ دَابَّةً مِّنَ الْأَرْضِ تُكَلِّمُهُمْ أَنَّ النَّاسَ لَغٰ كَانُوا بِآيَاتِنَا لَا يُوقِنُونَ ﴿٨٣﴾

84. Dhe (kujtoni) ditën kur Ne do të mbledhim një ushtri prej çdo populli që quajti gënjeshtër shenjat Tona, dhe më pas ata do të rreshtohen.

وَ يَوْمَ نَحْشُرُ مِنْ كُلِّ أُمَّةٍ فَوْجًا مِّمَّنْ يُكْذِبُ بِآيَاتِنَا فَهُمْ يُوزَعُونَ ﴿٨٤﴾

poshtë besimin e bijve të Izraelit rreth tyre, pasi ata besonin se ato të kishin ndodhur fizikisht.

12. Parafjala *alejhim* në kontekstin siç e ka ky ajet përkthehet "kundër tyre" dhe si e tillë, në këtë ajet, Allahu i Madhërishtëm paralajmëron ndëshkimin.

13. Fjala *dābbeh* (gjallesë nga toka) nënkupton pleshtin që do të bëhej mjet i përhapjes së murtajës në kohët e vona. Profeti Muhammed<sup>sav</sup>s gjithashtu e ka parashikuar daljen e kësaj gjallesë në kohët e vona (Tefsir Ibn Kethir) dhe në një hadith tjetër e përmendi si insekt. (Muslimi, Fiten, nr. 7373).



85. Derisa kur ata do të paraqiten (tek Allahu), Ai do t'i pyesë: A i quajttë gënjeshtria shenjat e Mia pa pasur dije rreth tyre? Ose çfarë është ajo që bënit ju?

86. Do të lëshohet vendimi kundër tyre për shkak të padrejtësisë që bënin. Atëherë ata nuk do të flasin dot.

87. A nuk panë se Ne bëmë natën që të qetësohen në të dhe ditën ndriçuese?! Në të ka shenja për njerëzit që besojnë.

88. Dhe ditën kur do t'i fryhet bririt, do të dridhet kushdo që është në qiej dhe kushdo që është në tokë, përveç atij që do Allahu. Të gjithë do të vijnë të përlurur tek Ai.

89. Ti sheh malet dhe mendon se ato janë të palëvizshme, kurse ato po lëvizin sikur lëvizin retë. Është mjeshtëria e Allahut, i cili nguliti fort çdo gjë. Pa dyshim, Ai është i Gjithinformuar për atë që bëni ju.<sup>14</sup>

90. Ai që sjell veprën e mirë, do të ketë (shpërblim) më të mirë se ajo. Dhe pikërisht këta atë ditë do të jenë të mbrojtur nga çdo shqetësim.

91. Dhe ai që sjell veprën e keqe, do të hidhet për fytyrë në zjarr. A do të shpërbleheni për ndonjë gjë tjetër përveç asaj që keni punuar?!

حَتَّىٰ إِذَا جَاءُو قَالَ أَكَذَّبْتُم بِآيَاتِي وَلَمْ تُحِطُوا بِهَا عِلْمًا أَمْ دَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ ﴿٨٥﴾

وَ وَقَعَ الْقَوْلُ عَلَيْهِمْ بِمَا ظَلَمُوا فَهُمْ لَا يَظُنُّونَ ﴿٨٦﴾

أَلَمْ يَرَوْا أَنَّا جَعَلْنَا الْآيَاتِ لِيَسْكُنُوا فِيهَا وَالنَّهَارَ مُبْصِرًا إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِّقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ ﴿٨٧﴾

وَ يَوْمَ يُفْعَخُ فِي الصُّورِ فَفَزِعَ مَنْ فِي السَّمَوَاتِ وَمَنْ فِي الْأَرْضِ إِلَّا مَنْ شَاءَ اللَّهُ ۗ وَكُلٌّ أَتَوْهُ دُخْرِينَ ﴿٨٨﴾

وَ تَرَى الْجِبَالَ تَحْسَبُهَا جَامِدَةً وَهِيَ تَمُرُّ مَرَّ السَّحَابِ ۗ صُنِعَ اللَّهُ الَّذِي أَتَقَنَ كُلِّ شَيْءٍ ۗ إِنَّهُ خَبِيرٌ بِمَا تَعْمَلُونَ ﴿٨٩﴾

مَنْ جَاءَ بِالْحَسَنَةِ فَلَهُ خَيْرٌ مِنْهَا ۗ وَهُمْ مِّنْ فَزَعِ يَوْمِذٍ مُّؤْتُونَ ﴿٩٠﴾

وَ مَنْ جَاءَ بِالسَّيِّئَةِ فَكَبَّتْ وَجُوهُهُمْ فِي النَّارِ ۗ هَلْ تُجْزَوْنَ إِلَّا مَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ ﴿٩١﴾

14. Ky ajet qartazi flet për rrotullimin e Tokës. Lexoni shpjegimin në parathënien e kësaj sureje.

92. “Sigurisht, unë jam urdhëruar të adhuroj Zotin e këtij qyteti, të cilin Ai e bëri të shenjtë dhe Atij i përket çdo gjë. Unë jam urdhëruar të bëhem i nënshtruar;<sup>15</sup>

93. dhe që të lexoj Kuranin.” Kështu pra, ai që udhëzohet, udhëzohet për veten e tij dhe ai që humb rrugën, atëherë thaj: “Unë jam vetëm një paralajmërues.”

94. Dhe thaj: “Lavdia është e Allahut! Ai së shpejti do t’ju tregojë shenjat e Tij, të cilat ju do t’i njihni. Zoti juaj nuk është i pavëmendshëm ndaj asaj që bëni.”

إِنَّمَا أُمِرْتُ أَنْ أَعْبُدَ رَبَّ هَذِهِ الْبَلَدَةِ  
الَّذِي حَرَّمَهَا وَلَهُ كُلُّ شَيْءٍ ۗ وَأُمِرْتُ أَنْ  
أَكُونَ مِنَ الْمُسْلِمِينَ ۝

وَأَنْ أَتْلُوا الْقُرْآنَ ۗ فَمَنْ اهْتَدَىٰ فَإِنَّمَا  
يَهْتَدِي لِنَفْسِهِ ۗ وَمَنْ ضَلَّ فَقُلْ إِنَّمَا أَنَا  
مِنَ الْمُنذِرِينَ ۝

وَقُلِ الْحَمْدُ لِلَّهِ سَبِّحْكُمْ آيَتِهِ فَتَعْرِفُونَهَا ۗ  
وَمَا رَبُّكَ بِغَافِلٍ عَمَّا تَعْمَلُونَ ۝

15. Të bëhem musliman.

## Surja 28 – El-Kasas

Kjo sure është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka tetëdhjetë e nëntë ajete.

Edhe kjo sure fillon me shkurtesat *Ta.Sin.Mim*, që do të thotë se vijon tema e emrave të Zotit *Tejyib (i Pastër, i Mirë), Semi' (Gjithëdëgjues)* dhe *'Elim (i Gjithëdijshëm)*, [siç është përmendur në dy suret paraardhëse.]

Në shumë ajete të sures së mëparshme u fol për shenjat madhështore që do të plotësoheshin në të ardhmen, kurse në këtë sure thuhet se Allahu i Madhërishtëm di edhe të kaluarën, siç di edhe të ardhmen. Në lidhje me këtë, Zoti i Madhërishtëm i shpalosi Profetit Muhammed<sup>savs</sup> faktet rreth *Hazret Musait<sup>as</sup>*, që flasin për mrekulli të ndryshme të Zotit. Nëse do ta përmblihdhim këtë, mund të themi se kjo sure tregon se i njëjti ujë që shpëtoi një fëmijë të pafajshëm si *Hazret Musai<sup>as</sup>*, e fundosi Faraonin bashkë me ushtritë e tij.

Pas kësaj, [në ajetin 49] Zoti i thotë Profetit Muhammed<sup>savs</sup>: Hebrenjtë e kohës sate të mohojnë ty dhe thonë se nuk do të të mohonin, po t'u tregojë shenjat siç ka treguar Musai, por ata harrojnë se ishin pikërisht hebrenjtë e sojit të tyre që mohuan shenjat që u shfaqën në epokën e Musait dhe anuan nga idhujtaria. Në këtë mënyrë, kjo sure tregoi se të gjithë ata që kundërshtojnë dhe mohojnë Profetët, si në të kaluarën, ashtu edhe në kohën e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, kanë një sjellje të shtrembër: pohojnë se gjoja besojnë në shenjat e së kaluarës, dhe të njëjtat shenja, kur shfaqen para tyre, i mohojnë.

Pas kësaj flitet për ithtarët e vërtetë të Librit, të cilët kanë pasur natyrë të pastër. Ata edhe më përpara besuan me bindje në vërtetësinë e *Hazret Musait<sup>as</sup>*, dhe kur panë mrekullitë e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, besuan edhe në të, dhe kështu merituan shpërblim të dyfishtë [ajeti 55]. Të tillët do të kenë shpërblim për shkak se besonin me bindje në vërtetësinë e *Hazret Musait<sup>as</sup>*, dhe shpërblim shtesë për shkak se besuan edhe në vërtetësinë e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>.

Përmbledhja e këtij diskutimi u përmend në këtë sure [në ajetin 57] duke thënë se njeriu udhëzimin nuk e fiton dot nga forca e tij, por Allahu i Madhërishtëm Vetë i udhëzon ata që janë të sinqertë. Në vijim, kjo sure gjithashtu pohon se popujt që janë shkatërruar në të kaluarën, u shkatërruan jo për shkak se Allahu i Madhërishtëm u bëri padrejtësi atyre, por ata janë bërë pre e padrejtësive të veta, të cilat i bënin kundër shpirtit të tyre dhe kundër Profetëve të kohës së tyre.

Pas kësaj, kjo sure e Kuranit të Shenjtë pohon se Zoti i Madhërishtëm nuk e lë njeriun të mbetet i zhytur në errësira, përkundrazi, ndodh ashtu siç alternohen netët dhe ditët. Duke dhënë dy shembuj [në ajetet 72 – 73] me një shprehësi të lartë, Zoti i Madhërishtëm u tërheq vëmendjen njerëzve dhe thotë:

Nëse Allahu do të caktonte natën në mënyrë të përhershme për ju, për shkak të errësirës, patjetër që nuk do të arrinit të shikonit diçka, por prapëseprapë, do të

mund të dëgjonit me veshët tuaj, prandaj, apo dëgjoni këtë thirrje?! Po kështu, nëse Ai do të caktonte ditën në mënyrë të përhershme për ju, atëherë edhe ata që nuk mund të dëgjojnë, të paktën do të mund të shohin rrugën, andaj, ju pse nuk shihni?!

Më pas kjo sure flet për Karunin, të cilit Zoti i kishte dhënë pasuri të madhe, aq sa çdokush ia kishte lakminë, megjithatë, ai pati një fund tragjik, aq sa u gropos bashkë me pallatet dhe pasuritë e tij. Po kjo sure që në fillim e tha se Allahu i Madhërisëm ka fuqi të përmbysë mohuesit e Tij që në tokë, e jo vetëm në det. Kështu ndodh edhe në këtë kohë. Nganjëherë bien tërmete në mënyrë kaq të fuqishme saqë vendbanime të tëra bashkë me pajimet e tyre moderne, groposen për një çast duke mos lënë asnjë shenjë jete.

Pas gjithë këtyre ajeteve, ajeti numër 86 është i mjaftueshëm si provë përkundërshtarët se ky Kuran është Fjala e Allahut dhe si e tillë, ajo plotësohet pashmangshmërisht. **Zoti pohon në këtë ajet:**

Ne patjetër do të të kthejmë ty në vendkthim (*me'ad*), pra në Mekë. Kundërshtarët e Profetit Muhammed<sup>savs</sup> e dëshmuan me sytë e tyre përmbushjen e kësaj profecie. Atëherë nuk mbetet arsye për të dyshuar as në ngjarjet e së kaluarës dhe as në profecitë që lidhen me të ardhmen, e që janë përmendur në këtë Kuran. Asgjë nuk është aq e qartë dhe aq e vërtetë sa është Njëshmëria e Allahut të Madhërisëm, përfundim ky që nxjerr kjo sure në ajetin e fundit. Pra, popujt që Zoti ka treguar shkatërrimet e tyre, janë shkatërruar jo vetëm ata, por do të asgjësohet çdo gjë dhe gjithçka që ekziston, në daç duke pësuar ndëshkimin nga zemërimi i Allahut, në daç duke iu nënshtruar ligjeve të natyrës. Vetëm Allahu është Ai që do të mbetet përgjithmonë me manifestimin e Tij.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. *Ta.Sin.Mim.* (I Pastër, Gjithëdëgjues, i Gjithëdijshëm.)

طَسْمًا ②

3. Këto janë ajete të Librit të qartë.

تِلْكَ آيَاتُ الْكِتَابِ الْمُبِينِ ③

4. Ne të lexojmë ty disa nga lajmet e Musait dhe të Faraonit me vërtetësi për njerëzit që besojnë.

نَتْلُو عَلَيْكَ مِنْ نَبَأِ مُوسَى وَفِرْعَوْنَ بِالْحَقِّ لِقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ ④

5. Faraoni u rebelua në tokë dhe i përçau banorët e saj në grupe. Ai përndiqte një grup të tyre. Ua therte djemtë dhe gratë ua mbante të gjalla. Ishte vërtet keqbërës.

إِنَّ فِرْعَوْنَ عَلَا فِي الْأَرْضِ وَجَعَلَ أَهْلَهَا شِيَعًا يَسْتَضِعُّ طَائِفَةً مِنْهُمْ يَدْخِجُ آبَاءَهُمْ وَيَسْتَجِي نِسَاءَهُمْ ⑤ إِنَّهُ كَانَ مِنَ الْمُفْسِدِينَ ⑥

6. Dhe Ne deshëm t'u bënim mirësi atyre që u persekutuan në tokë, t'i bënim ata udhëheqës dhe trashëgimtarë,

وَتُرِيدُ أَنْ نَمُنَّ عَلَى الَّذِينَ اسْتُضِعُوا فِي الْأَرْضِ وَنَجْعَلَهُمُ الْأُورَثِينَ ⑦

7. dhe t'i forconim ata në tokë dhe t'u tregonim Faraonit, Hamanit dhe ushtrive të tyre nëpërmjet atyre (pra, bijve të Izraelit) atë që ata i kishin frikë.

وَنُمَكِّنَ لَهُمْ فِي الْأَرْضِ وَنُرِي فِرْعَوْنَ وَهَامَانَ وَجُودَهُمَا مِنْهُمْ مَا كَانُوا يَحْذَرُونَ ⑧

8. Ne i shpallëm nënës së Musait që atij t'i jepte gji (dhe i thamë): “Kur të kesh frikë për të, hidhe në lumë dhe as mos u frikëso e as mos u brengos!

وَأَوْحَيْنَا إِلَىٰ أُمِّ مُوسَىٰ أَنْ أَرْضِعِيهِ ⑨ فَإِذَا خِفْتِ عَلَيْهِ فَأَلْقِيهِ فِي الْيَمِّ وَلَا

Ne sigurisht që do të ta kthejmë ty dhe do ta bëjmë atë ndër të dërguarit.”<sup>1</sup>

9. Atëherë (sipas caktimit Tonë) atë e mori familja e Faraonit, që (në të ardhmen) të bëhej për ta armik dhe (t’u sillte) brengë. Pa dyshim, Faraoni, Hamani dhe ushtritë e tyre ishin fajtorë.

10. Gruaja e Faraonit tha: “U bëftë prehja e syve për mua e për ty! Mos e vrit! Mundet që të na sjellë dobi ose ta birësojmë”, por ata nuk kuptonin.

11. Iu lirua zemra (nga ankthi) nënës së Musait. Mundej që ajo ta zbulonte këtë (sekret), po të mos ia kishim forcuar Ne zemrën asaj. (Këtë e bëmë) që ajo të bëhej ndër besimtarët.

12. Ajo i tha motrës së tij: “Ndiqe (fëmijën)!” Pra, ajo e shikonte atë nga larg, ndërkohë që ata nuk e dinin.

13. Më parë Ne bëmë të ndaluara mëndeshat për të, atëherë (motra e tij) u tha atyre: “A t’ju tregoj për një familje që mund të kujdeset për të për (hir) tuajin, dhe që do të jenë edhe dashamirës të tij?”

تَخَافِي وَلَا تَحَرِّنِي ۚ إِنَّا رَادُّوهُ إِلَيْكَ  
وَجَاعَلُوهُ مِنَ الْمُرْسَلِينَ ۝۸

فَالْتَقَطَهُ آلُ فِرْعَوْنَ لِيَكُونَ لَهُمْ عَدُوًّا  
وَّحَرْنًا ۚ إِنَّ فِرْعَوْنَ وَهَامَانَ وَجُنُودَهُمَا  
كَانُوا خَاطِبِينَ ۝۹

وَقَالَتِ امْرَأَتُ فِرْعَوْنَ قُرَّتْ عَيْنِي لِي  
وَلَكَ ۗ لَا تَقْتُلُوهُ ۗ عَسَىٰ أَنْ يَنْفَعَنَا أَوْ  
نَتَّخِذَهُ وَلَدًا وَهُمْ لَا يَسْعُرُونَ ۝۱۰

وَأَصْبَحَ فُؤَادُ أُمِّ مُوسَىٰ فِرْعَاطًا ۚ إِنَّ  
كَادَتْ لَتُبْدِي بِهِ لَوْلَا أَنْ رَبَّنَا عَلَىٰ قَلْبِهَا  
لَيَكُونَ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ ۝۱۱

وَقَالَتِ لِأُخْتِهِ قُصِيهِ ۗ فَبَصُرَتْ بِهِ عَنْ  
جُنُبٍ وَهُمْ لَا يَسْعُرُونَ ۝۱۲

وَحَرَّمْنَا عَلَيْهِ الْمَرَاصِعَ مِنْ قَبْلُ فَقَالَتْ  
هَلْ أَدُلُّكُمْ عَلَىٰ أَهْلِ بَيْتٍ يَكْفُلُونَهُ  
لَكُمْ وَهُمْ لَهُ نَاصِحُونَ ۝۱۳

1. Ai që beson në Allahun e Madhërishtëm dhe në Kuranin e Shenjtë, e ka për detyrë të besojë edhe që Allahu komunikon përmes shpalljes (*vahj, ilham* etj.) me cilindo nga robërit e Tij, qoftë ky rob të jetë i Dërguar a Profet i Tij, ose jo. Ky ajet tregon se Allahu komunikoi përmes shpalljes me nënën e *Hazret Musait*<sup>as</sup> dhe i tha “*as mos u frikëso e as mos u brengos ...*”. Po kështu, Ai komunikoi me dishepujt e *Hazret Isait*<sup>as</sup>, me Dhul-Kernejnin etj.. Lexoni edhe 42:52; 41:31-32.

14. Kështu Ne e kthyem atë te nëna e tij, në mënyrë që asaj t'i qetësoheshin sytë, të mos brengosej dhe të mësonte se premtimi i Allahut është i vërtetë, por shumica e tyre nuk e dinë.

15. Kur (Musai) arriti pjekurinë dhe u formua, i dhamë urtësinë dhe dijen. Ne kështu shpërblejmë mirëbërësit.

16. (Një ditë) ai hyri në qytet në një kohë kur banorët e tij nuk ishin të vëmendshëm, atëherë atje gjeti dy burra që luftonin me njëri-tjetrin: njëri ishte nga grupi i tij dhe tjetri prej armiqve të tij. Ai që qe nga grupi i tij e thirri (Musain) për ndihmë kundër atij që ishte prej armiqve të tij. Musai e qëllloi me grusht dhe e vrau në vend. (Musai) tha (me vete): “Kjo (që u bë) ishte vepër djalli; njëmend, ai është armik dhe ngatërrestar i qartë!”<sup>2</sup>

17. Tha: “O Zoti im! I kam bërë keq vetvetes, më fal mua!” Dhe Ai e fali atë. Sigurisht, Ai është Falësi, Mëshirëbërësi.

18. Tha: “O Zoti im! Për mirësinë që më bërë mua, kurrë më nuk do të ndihmoj fajtorët.”

19. Mëngjesi e gjeti në qytet dhe tek po dilte i frikësuar (dhe) duke u ruajtur, papritmas ai që i kërkoi ndihmë dje, po e thërriste prapë për shpëtim. Musai i tha: “Ti për njëmend je ngatërrestar i hapët!”

فَرَدَدْنَاهُ إِلَىٰ أُمِّهِ كَيْ تَقَرَّ عَيْنُهَا وَلَا تَحْزَنَ ۗ وَلِتَعْلَمَ أَنَّ وَعْدَ اللَّهِ حَقٌّ وَلَٰكِنَّ أَكْثَرَهُمْ لَا يَعْلَمُونَ ﴿١٤﴾

وَلَمَّا بَلَغَ أَشُدَّهُ ۖ وَاسْتَوَىٰ أَيْنُهُ حُكْمًا وَعِلْمًا ۗ وَكَذَٰلِكَ نَجْزِي الْمُحْسِنِينَ ﴿١٥﴾

وَدَخَلَ الْمَدِينَةَ عَلَىٰ حِينٍ عُفْلَةٍ مِّنْ أَهْلِهَا فَوَجَدَ فِيهَا رَجُلَيْنِ يَقْتَتِلَانِ هَٰذَا مِنْ شِيعَتِهِ وَهَٰذَا مِنْ عَدُوِّهِ ۖ فَاسْتَعَاثَ الَّذِي مِنْ شِيعَتِهِ عَلَى الَّذِي مِنْ عَدُوِّهِ ۗ فَوَكَرَهُ مُوسَىٰ فَقَضَىٰ عَلَيْهِ ۗ قَالَ هَٰذَا مِنْ عَمَلِ الشَّيْطَانِ ۗ إِنَّهُ عَدُوٌّ مُّضِلٌّ مُّبِينٌ ﴿١٦﴾

قَالَ رَبِّ إِنِّي ظَلَمْتُ نَفْسِي فَاغْفِرْ لِي ۖ فَغَفَرْنَا لَهُ ۗ إِنَّهُ هُوَ الْغَفُورُ الرَّحِيمُ ﴿١٧﴾

قَالَ رَبِّ بِمَا أَنْعَمْتَ عَلَيَّ فَلَنْ أَكُونَ ظَهِيرًا لِّلْمُجْرِمِينَ ﴿١٨﴾

فَأَصْبَحَ فِي الْمَدِينَةِ خَائِفًا يَتَرَقَّبُ ۖ فَإِذَا الَّذِي اسْتَنْصَرَهُ بِالْأَمْسِ يَسْتَصْرِحُهُ ۗ قَالَ لَهُ مُوسَىٰ إِنَّكَ لَعَوِيٌّ مُّبِينٌ ﴿١٩﴾

2. Fjalët e Hazret Musait<sup>as</sup> “kjo (që u bë) ishte vepër djalli” nënkuptojnë – djalli futi zemërimin midis njeriut të popullit tim dhe atij të popullit të Faraonit dhe shkaktoi grindjen, dhe për këtë arsye, mua m’u desh ta ndihmoja njeriun e popullit tim, pasi ai ishte i shtypur.

20. Pas kësaj, kur (Musai) deshi ta shtrëngonte atë që qe armik i atyre të dyve, ai tha: “O Musa! A dëshiron të më vrasësh edhe mua siç vrave dje një njeri (tjetër)?! Ti do që të jesh vetëm tiran në tokë dhe nuk dëshiron të bëhesh përmirësues!”

21. Erdhi një njeri duke vrapuar nga skaji i qytetit (dhe) tha: “O Musa! Prijësit po bëjnë plane kundër teje që të të vrasin, andaj, arratisu! Jam vërtet një dashamirës yti.”

22. Atëherë ai doli prej andej, i frikësuar dhe duke u ruajtur. Tha: “O Zoti im! Më shpëto nga populli keqbërës!”<sup>3</sup>

23. Kur ai iu drejtua Medjenit, tha: “Shpresoj se Zoti im të më udhëzojë në rrugën e saktë.”

24. E kur arriti te një (burim) uji të Medjenit, atje pa një grup njerëzish që po u jepnin ujë (bagëtive të tyre), dhe, pak më larg tyre, gjeti edhe dy gra që po mbanin larg bagëtitë e veta. U tha (grave): Çfarë ka ngjarë me

فَلَمَّا أَنْ أَرَادَ أَنْ يَنْطَشَ بِالَّذِي هُوَ عَدُوٌّ  
لَهُمَا قَالَ يَا مُوسَى أَتُرِيدُ أَنْ تَقْتُلَنِي كَمَا  
قَتَلْتَ نَفْسًا بِالْأَمْسِ ۗ إِنَّ تُرِيدُ إِلَّا أَنْ  
تَكُونَ جَبَّارًا فِي الْأَرْضِ وَمَا تُرِيدُ أَنْ  
تَكُونَ مِنَ الْمُصْلِحِينَ ۝

وَجَاءَ رَجُلٌ مِنْ أَقْصَا الْمَدِينَةِ يَسْعَى قَالَ  
يَا مُوسَى إِنَّ الْمَلَائِكَةَ يَتَمَرُّونَ بِكَ لِيُقْتُلُوكَ  
فَاخْرُجْ إِنِّي لَكَ مِنَ النَّاصِحِينَ ۝

فَخَرَجَ مِنْهَا خَائِفًا يَتَرَقَّبُ ۗ قَالَ رَبِّ  
نَجِّنِي مِنَ الْقَوْمِ الظَّالِمِينَ ۝

وَلَمَّا تَوَجَّهَ تَلْقَاءَ مَدْيَنَ قَالَ عَسَى رَبِّي  
أَنْ يَهْدِيَني سَوَاءَ السَّبِيلِ ۝

وَلَمَّا وَرَدَ مَاءَ مَدْيَنَ وَجَدَ عَلَيْهِ أُمَّةً مِنَ  
النَّاسِ يَسْقُونَ ۗ وَوَجَدَ مِنْ دُونِهِمُ  
امْرَأَتَيْنِ تَذُودَانِ ۗ قَالَ مَا خَطْبُكُمَا قَالَتَا

3. Ajetet 16 – 23 tregojnë se *Hazret Musai*<sup>as</sup>, përpara se të bëhej Profet, vinte në shtëpinë e tij, në errësirë, në orët e para të mëngjesit. Një ditë rrugës ai pa një izraelit që po luftonte me një njeri të popullit të Faraonit. Kur izraeliti e thirri për ndihmë, *Hazret Musai* e goditi me grusht njeriun e Faraonit kaq fort, sa që ai u vra në vend.

Të nesërmen, përsëri herët në mëngjes, kur *Hazret Musai* po shkonte në shtëpi, pa që i njëjti izraelit po grindej me një tjetër njeri të popullit të Faraonit. Kur *Musai*<sup>as</sup> u mat për të ndihmuar sërish njeriun e fisit të tij, ai i Faraonit i tërhoqi vërejtjen *Musait* duke thënë: A do të më vrasësh edhe mua siç vrave dje një person tjetër tonin? Pas këtyre dy ngjarjeve është ajeti që tregon se paria e Faraonit kishte marrë vendimin se do ta vrisnin *Musain*, lajm të cilin ia kishte dhënë *Musait* një dashamirës i tij. Atëherë *Hazret Musai*<sup>as</sup> mërgoi nga atje drejt Medjenit.



ju? Ato thanë: “Nuk u japim dot ujë, derisa të largohen barinjtë; babai ynë është shumë i moshuar.”

25. Atëherë për t'i ndihmuar ato, ai u dha ujë (bagëtime). Më pas kaloi në hije dhe tha: “O Zoti im! Çdo mirësi që më dërgon, jam vërtet lypës i saj.”

26. Njëra prej tyre erdhi e turpshme tek ai. Tha: “Babai im po të thërret që të të shpërblejë për (shërbimin) që u dha ujë (bagëtime) tona.” E kur (Musai) erdhi tek ai dhe ia rrëfeu gjithë ngjarjen, ai tha: “Mos ki frikë! Shpëtove nga populli keqberës.”

27. Njëra prej të dyjave tha: “O babai im! Merre këtë në punë. Sigurisht, më i miri nga ata që merr në punë, është ai që është i fortë (dhe) i besueshëm.”

28. (Babai i tyre) i tha (Musait): “Dua të të martoj ty me njëren prej këtyre dy bijave të mia, me kushtin që ti të punosh tek unë për tetë vjet, por nëse plotëson dhjetë (vjet), do të jetë shtesë nga ana jote. Nuk dua të të rëndoj ty. Në dashtë Allahu, do të më gjesh njeri të sinqertë.”

29. (Musai) tha: “Kështu le të jetë (e vendosur) mes meje e teje, cilindo nga dy afatet të plotësoj unë, nuk duhet bërë padrejtësi ndaj meje. Allahu është Mbikëqyrës mbi atë që kemi pohuar bashkë.”

لَا نَسْتَعِي حَتَّىٰ يُصَدِرَ الرَّعَاءُ سِنَّةً وَأَبُونَا  
شَيْخٌ كَبِيرٌ ﴿٢٥﴾

فَسَقَىٰ لَهُمَا ثُمَّ تَوَلَّىٰ إِلَى الظِّلِّ فَقَالَ  
رَبِّ إِنِّي لِمَا أَنْزَلْتَ إِلَيَّ مِنْ خَيْرٍ فَقِيرٌ ﴿٢٦﴾

فَجَاءَتْهُ إِحْدَاهُمَا تَمْسِي عَلَىٰ اسْتِحْيَاءٍ  
قَالَتْ إِنَّ أَبِي يَدْعُوكَ لِيَجْزِيَكَ أَجْرَ مَا  
سَقَيْتَ لَنَا فَلَمَّا جَاءَهُ وَقَصَّ عَلَيْهِ  
الْقَصَصَ لَقَالَ لَا تَخَفْ نَبَّخْتُ مِنْ النَّوْمِ  
الظُّلْمِينَ ﴿٢٧﴾

قَالَتْ إِحْدَاهُمَا يَا أَبَتِ اسْتَأْجِرْهُ إِنَّ خَيْرَ  
مَنْ اسْتَأْجَرْتَ الْقَوِيُّ الْأَمِينُ ﴿٢٨﴾

قَالَ إِنِّي أُرِيدُ أَنْ أُنكِحَكَ إِحْدَى  
ابْنَتَيْ هَاتَيْنِ عَلَىٰ أَنْ تَأْجُرَنِي ثَمَنِي حِجَابٍ  
فَإِنْ أَمَمْتَ عَشْرًا فَمِنْ عِنْدِكَ وَمَا  
أُرِيدُ أَنْ أَسْفُقَ عَلَيْكَ سَتَجِدُنِي إِنْ شَاءَ  
اللَّهُ مِنَ الصَّالِحِينَ ﴿٢٩﴾

قَالَ ذَلِكَ بَيْنِي وَبَيْنَكَ أَيَّمَا الْأَجْلَيْنِ  
قَضَيْتُ فَلَا عُدْوَانَ عَلَيَّ وَاللَّهُ عَلَىٰ مَا  
نَقُولُ وَكِيلٌ ﴿٣٠﴾

30. Dhe kur Musai e plotësoi afatin dhe u nis së bashku me familjen e tij, pa një zjarr afër Turit. I tha familjes: “Qëndroni këtu. Kam parë një zjarr. Ndoshta do t’ju sjell ndonjë lajm prej tij, ose do t’ju sjell një urë të ndezur, që të ngrohni ju.”

31. E kur ai iu afrua atij (zjarri), prej anës së luginës së bekuar, nga pjesa e bekuar e pemës, u thirr: “O Musa! Unë jam Allahu, Zoti i botëve!”

32. Dhe (vijoi): “Hidhe shkopin tënd!” E kur e pa atë që po zhdërvillej, sikur të ishte një gjarpër, ai iku duke treguar shpinën dhe nuk u kthye. “O Musa, afrohu dhe mos ki frikë! Sigurisht, je i mbrojtur.

33. Fute dorën në kraharorin tënd, ajo do të dalë e bardhë pa ndonjë të metë. Dhe shtrëngoje dorën te vetja (që të lirohesh) nga frika. Të dyja këto janë shenjat prej Zotit tënd, (të dërguara) për Faraonin dhe parinë e tij. Pa dyshim, ata janë popull i mosbindur.”

34. (Musai) tha: “O Zoti im! Kam vrarë një njeri prej tyre, andaj, kam frikë se do të më vrasin.

35. Dhe vëllai im Haruni, është më elokuent se unë, pra, dërgoje atë bashkë me mua si ndihmës, ai do të më vërtetojë. Kam frikë se do të më quajnë gënjeshtar.”

فَلَمَّا قَضَىٰ مُوسَى الْأَجَلَ وَسَارَ بِأَهْلِهِ  
آنَسَ مِنْ جَانِبِ الطُّورِ نَارًا قَالَ لِأَهْلِهِ  
امْكُثُوا إِنِّي آنَسْتُ نَارًا تَعَلَّىٰ آتِيكُمْ مِنْهَا  
بِخَبْرٍ أَوْ جَذْوَةٍ مِنَ النَّارِ لَعَلَّكُمْ  
تَصْطَلُونَ ﴿٣٠﴾

فَلَمَّا أَتَاهَا نُودِيَ مِنْ شَاطِئِ الْأَوْدِ الْأَيْمَنِ  
فِي الْبُقْعَةِ الْمُبْرَكَةِ مِنَ الشَّجَرَةِ أَنْ  
يُؤَسِّىٰ إِلَيَّ أَنَا اللَّهُ رَبُّ الْعَالَمِينَ ﴿٣١﴾

وَأَنْ أَلْقِ عَصَاكَ فَلَمَّا رَآهَا تَهْتَزُّ  
كَأَنَّهَا جَانٌّ وَوَلِيٌّ مُدْبِرًا وَلَمْ يُعَقِّبْ  
يُؤَسِّىٰ أَقْبِلْ وَلَا تَخَفْ إِنَّكَ مِنَ  
الْأَمِينِينَ ﴿٣٢﴾

أَسْلَكَ يَدَكَ فِي جَيْبِكَ تَخْرُجُ بَيْضَاءَ  
مِنْ غَيْرِ سَوَاءٍ وَأَصْمَمُ إِلَيْكَ جَانْحَكَ  
مِنَ الرَّهْبِ فَذُنُوكَ بُرْهَانِنِ مِنْ رَبِّكَ إِلَى  
فِرْعَوْنَ وَمَلَئِهِ لَأَتَّهُمْ كَانُوا قَوْمًا  
فَاسِقِينَ ﴿٣٣﴾

قَالَ رَبِّ إِنِّي قَتَلْتُ مِنْهُمْ نَفْسًا فَأَخَافُ  
أَنْ يَقْتُلُونِ ﴿٣٤﴾

وَإِخِي هَارُونَ هُوَ أَفْصَحُ مِنِّي لِسَانًا  
فَأَرْسَلَهُ مَعِيَ رِدْءًا يُصَدِّقُنِي إِنِّي أَخَافُ  
أَنْ يُكَذِّبُونِ ﴿٣٥﴾

36. (Zoti) tha: “Ne do të të forcojmë krahun përmes vëllait tënd dhe ju të dyve do t’ju japim shenjë mbizotëruese, dhe ata nuk mund t’ju prekin dot përballë shenjave Tona. Ju dhe ata që do t’ju ndjekin, do të triumfojnë.”

37. Kur Musai shkoi te ta me shenjat Tona të qarta, ata thanë: “Kjo është vetëm një magji e sajuar dhe këtë nuk e kemi dëgjuar tek etërit tanë të parë.”

38. Musai tha: “Zoti im e di më së miri se kush e solli udhëzimin prej Tij dhe se kush është ai që do të gëzojë shtëpinë e *ahiretit*. Sigurisht, keqbërësit nuk gëzojnë sukses.”

39. Faraoni tha: “O oborrtarë! Nuk njoh për ju ndonjë të adhurueshëm tjetër përveç meje. Prandaj, o Haman! Ndizmë një zjarr mbi (tulla) dheu dhe më bëj një pallat, që të vëzhgoj pak të adhuruarin e Musait. Njëmend, atë e mendoj një gënjeshtar.”

40. Ai dhe ushtritë e tij u treguan mendjemëdhenj në tokë, pa të drejtë, dhe menduan se nuk do të kthehen te Ne.

41. Atëherë Ne i kapëm atë dhe ushtritë e tij, i flakëm në det. Shiko, pra, si ishte fundi i keqbërësve.

42. I kishim bërë udhëheqës që thërrisnin drejt zjarrit, dhe Ditën e Kiametit ata nuk do të ndihmohen.

قَالَ سَنَشُدُّ عَضُدَكَ بِأَخِيكَ وَنَجْعَلُ لَكُمَا سُلْطٰنًا فَلَا يَصِلُونَ إِلَيْكُمَا بِآيٰتِنَا ۗ أَنْتُمْ وَمَنِ اتَّبَعَكُمَا الْغٰلِبُونَ ﴿٣٦﴾

عَالِقَةَ ۙ

فَلَمَّا جَاءَهُمْ مُوسَىٰ بِآيٰتِنَا بَيِّنٰتٍ قَالُوا مَا هٰذَا إِلَّا سِحْرٌ مُّفْتَرًى وَمَا سَمِعْنَا بِهٰذَا فِيٰ آبَائِنَا الْأَوَّلِينَ ﴿٣٧﴾

وَقَالَ مُوسَىٰ رَبِّيٰٓ أَعْلَمُ بِمَنْ جَاءَ بِالْهُدٰى مِنْ عِنْدِهِ وَمَنْ تَكُونُ لَهُ عَاقِبَةُ الدَّارِ ۗ إِنَّهُ لَا يُفْلِحُ الظَّالِمُونَ ﴿٣٨﴾

وَقَالَ فِرْعَوْنُ يٰٓأَيُّهَا الْمَلَأَ مَا عَلِمْتُ لَكُم مِّنْ إِلٰهٍ غَيْرِي ۚ فَأَوْقِدْ لِي يٰهَامٰنُ عَلَى الطَّيْنِ فَجَعَلْ لِي صَرْحًا لَّعَلِّيٓ أَطَّلِعُ إِلَىٰ إِلٰهِ مُوسَىٰ ۗ وَإِنِّي لَأَظُنُّهُ مِنَ الْكٰذِبِينَ ﴿٣٩﴾

وَاسْتَكْبَرَ هُوَ وَجُودُهُ فِي الْأَرْضِ بِغَيْرِ الْحَقِّ وَظَنُّوا أَنَّهُم إِلَيْنَا لَا يُرْجَعُونَ ﴿٤٠﴾

فَأَخَذْنَاهُ وَجُودَهُ فَبَبَدْنَاهُمْ فِي الْيَوْمِ ۗ فَأَنْظُرْ كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ الظَّالِمِينَ ﴿٤١﴾

وَجَعَلْنَاهُمْ آيَةً يَدْعُونَ إِلَى التَّارِ ۗ وَيَوْمَ الْقِيٰمَةِ لَا يُنصَرُونَ ﴿٤٢﴾

43. Ne lëshuam një mallkim që t'i ndjekë pas në këtë botë; dhe Ditën e Kiametit ata do të jenë të mjeruar.

44. Pasi i kishim shkatërruar popujt e parë, i dhamë Musait Librin si ndriçues, udhëzim dhe mëshirë për njerëzit, që ata të reflektojnë.

45. Nuk ke qenë ti pranë pjesës lindore (të Turit), kur Ne i dërguam Musait urdhrin, dhe ti nuk ishe dëshmitar (okular).

46. Ne ngritëm shumë popuj, aq sa atyre iu zgjat jeta. Dhe nuk u recitoje ti ajetet Tona banorëve të Medjenit, por jemi Ne që dërgonim të dërguar.

47. Nuk ishe as anës Turit kur Ne e thirrëm (Musain), por (ti je) si mëshirë prej Zotit tënd, që të paralajmërosh një popull, të cilit nuk i ka ardhur ndonjë alarmues përpara teje, që ata të reflektojnë.

48. Mundet që ata t'i zërë ndonjë fatkeqësi për shkak të asaj që duart e tyre e çuan përpara, atëherë ata do të thoshin: “O Zoti ynë! Pse nuk na dërgove ndonjë të dërguar, që të ndiqnim ajetet e Tua dhe të bëheshim besimtarë?”

49. E kur u erdhi e vërteta prej Nesh, thanë: “Pse këtij nuk iu dha ajo që i ishte dhënë Musait?” Vallë, këta a nuk e mohonin atë që i ishte dhënë Musait më përpara?! Thoshin: “Këta

وَاتَّبَعَهُمْ فِي هَذِهِ الدُّنْيَا لَعْنَةً ۗ وَيَوْمَ  
الْقِيَامَةِ هُمْ مِنَ الْمَقْبُوحِينَ ۝٤٣

وَلَقَدْ آتَيْنَا مُوسَى الْكِتَابَ مِنْ بَعْدِ مَا  
أَهْلَكْنَا الْقُرُونَ الْأُولَىٰ بَصَائِرَ لِلنَّاسِ  
وَهُدًى وَرَحْمَةً لَّعَلَّهُمْ يَتَذَكَّرُونَ ۝٤٤

وَمَا كُنْتَ بِجَانِبِ الْغُرِيِّ إِذْ قَضَيْنَا إِلَىٰ  
مُوسَى الْأَمْرَ وَمَا كُنْتَ مِنَ الشَّاهِدِينَ ۝٤٥

وَلَكِنَّا أَنْشَأْنَا قُرُونًا فَتَطَاوَلَ عَلَيْهِمُ  
الْعُمُرُ ۗ وَمَا كُنْتَ ثَاوِيًّا فِي أَهْلِ مَدْيَنَ  
تَتْلُوا عَلَيْهِمُ الْبَيِّنَاتِ ۗ وَلَكِنَّا كُنَّا مُرْسِلِينَ ۝٤٦  
وَمَا كُنْتَ بِجَانِبِ الطُّورِ إِذْ نَادَيْنَا وَلَكِنْ  
رَحْمَةً مِنْ رَبِّكَ لِتُنذِرَ قَوْمًا مِمَّا أَتَاهُمْ مِنْ  
نَذِيرٍ ۖ مِنْ قَبْلِكَ لَعَلَّهُمْ يَتَذَكَّرُونَ ۝٤٧

وَلَوْلَا أَنْ تُصِيبَهُمْ مُصِيبَةٌ بِمَا قَدَّمَتْ  
أَيْدِيهِمْ فَيَقُولُوا رَبَّنَا لَوْلَا أَرْسَلْتَ إِلَيْنَا  
رَسُولًا فَتَتَّبِعَ إِلَيْكَ وَنَكُونَ مِنَ  
الْمُؤْمِنِينَ ۝٤٨

فَلَمَّا جَاءَهُمُ الْحَقُّ مِنْ عِنْدِنَا قَالُوا  
لَوْلَا أُوْتِيَ مِثْلَ مَا أُوتِيَ مُوسَىٰ ۗ أَوْ لَمْ  
يَكْفُرُوا بِمَا أُوتِيَ مُوسَىٰ مِنْ قَبْلِ ۗ قَالُوا

janë dy magjistarë që bashkëpunojnë me njëri-tjetrin.” Dhe thoshin: “Ne mohojmë gjithsecilin”.

50. Thuaju: “Nëse jeni të vërtetë, sillni ndonjë libër prej Allahut që të jetë më shumë udhëzues sesa këta të dy (pra, Teurati dhe Kurani), unë do ta ndjek atë.”

51. Nëse ata nuk të përgjigjen, dije se ata po ndjekin vetëm dëshirat e tyre. E kush është më i devijuari sesa ai që ndjek dëshirat e veta, pa pasur udhëzim prej Allahut?! Sigurisht, Allahu nuk e udhëzon popullin keqbërës.

52. Pa dyshim, Ne ua kemi përçarur fjalën që ata të reflektojnë.

53. (Shumë prej atyre) që u kemi dhënë Librin edhe më parë, besojnë edhe këtë (Kuran).

54. Kur atyre u lexohet (Kurani), thonë: “Ne besojmë në të; ky pa dyshim është i vërteti prej Zotit tonë dhe ne edhe më përpara kemi qenë të nënshtruar.”

55. Pikërisht këtyre do t’u jepet shpërblimi dyfish për shkak se duruan, dhe se këta e largojnë të keqen me të mirë dhe shpenzojnë nga ajo që u kemi dhënë.

56. Dhe kur dëgjojnë diçka të kotë, shmangen prej saj dhe thonë: “Ne

سِحْرَانِ تَطَهَّرَا ۖ وَقَالُوا إِنَّا بِكُلِّ  
كَفَرُونَ ﴿٥٠﴾

قُلْ فَأْتُوا بِكِتَابٍ مِّنْ عِنْدِ اللَّهِ هُوَ أَهْدَىٰ  
مِنْهُمَا أَتَّبِعُهُ ۖ إِنَّ كُنْتُمْ صَادِقِينَ ﴿٥١﴾

فَإِنْ لَّمْ يَسْتَجِيبُوا لَكَ فَاعْلَمْ أَنَّمَا  
يَتَّبِعُونَ أَهْوَاءَهُمْ ۗ وَمَنْ أَضَلُّ مِمَّن  
اتَّبَعَ هَوَاهُ بِغَيْرِ هُدًى مِّنَ اللَّهِ ۗ إِنَّ اللَّهَ  
لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الظَّالِمِينَ ﴿٥٢﴾

وَلَقَدْ وَصَّلْنَا لَهُمُ الْقَوْلَ لَعَلَّهُمْ  
يَتَذَكَّرُونَ ﴿٥٣﴾

الَّذِينَ آتَيْنَاهُمُ الْكِتَابَ مِنْ قَبْلِهِ هُمْ بِهِ  
يُؤْمِنُونَ ﴿٥٤﴾

وَإِذَا يُتْلَىٰ عَلَيْهِمْ قَالُوا آمَنَّا بِهِ ۖ إِنَّهُ الْحَقُّ  
مِن رَّبِّنَا ۗ إِنَّا كُنَّا مِنْ قَبْلِهِ مُسْلِمِينَ ﴿٥٥﴾

أُولَٰئِكَ يُؤْتَوْنَ أَجْرَهُمْ مَرَّتَيْنِ بِمَا  
صَبَرُوا ۖ وَ يَدْرَأُونَ بِالْحَسَنَةِ السَّيِّئَةَ  
وَمَا رَزَقْنَاهُمْ يُنْفِقُونَ ﴿٥٦﴾

وَإِذَا سَمِعُوا اللَّغْوَ أَعْرَضُوا عَنْهُ ۖ وَقَالُوا

kemi veprat tona dhe ju keni veprat tuaja; paqja qoftë mbi ju! Nuk anojmë nga të paditurit!”

57. Ti nuk mund të udhëzosh atë që do, por Allahu udhëzon kë të dojë dhe Ai i di më së miri ata që udhëzohen.

58. Ata thanë: “Nëse ndjekim udhëzimin bashkë me ty, do të na dëbojnë nga vendi ynë.” A nuk i kemi forcuar Ne në një vend të shenjtë (dhe) të sigurt, ku vijnë frutat e çdolloji si ushqim prej Nesh?! Por shumica prej tyre nuk e dinë.

59. Sa shumë vendbanime kemi shkatërruar, të cilat mburreshin për jetesën e tyre! Ja, këto janë shtëpitë e tyre, të cilat pas tyre nuk u populluan më, por shumë pak. Dhe jemi Ne Trashëgimtarët.

60. Zoti yt nuk i shkatërronte vendbanimet, derisa nuk ngrinte në amën e këtyre (vendbanimeve) një të dërguar, që ua recitonte ajetet Tona. Ne nuk jemi shkatërrues të vendbanimeve, përveçse nëse banorët e tyre bëhen keqbërës.

61. Çdo gjë që ju jepet juve, është përfitim i shkurtër i kësaj bote dhe zbukurim i saj. Kurse ajo që është tek Allahu, është më e mirë dhe më e qëndrueshme. A nuk kuptoni?!

62. Atëherë, atij që i kemi bërë

لَنَّا أَعْمَلْنَا وَلَكُمْ أَعْمَالُكُمْ ۖ سَلِّمْ  
عَلَيْكُمْ ۖ لَا نَبْتَغِي الْجَاهِلِينَ ﴿٥٧﴾

إِنَّكَ لَا تَهْدِي مَنْ أَحْبَبْتَ وَلَكِنَّ  
اللَّهَ يَهْدِي مَنْ يَشَاءُ ۚ وَهُوَ أَعْلَمُ  
بِالْمُهْتَدِينَ ﴿٥٧﴾

وَقَالُوا إِن تَتَّبِعِ الْهَلْدَىٰ مَعَكَ نُحْظِفْ  
مِنْ أَرْضِنَا أَوْ لَمْ نُمَكِّنْ لَهُمْ حَرَمًا  
أِمَّا يُجَبَىٰ إِلَيْهِ تَمَرْتُ كُلِّ شَيْءٍ رِّزْقًا مِّنْ  
لَّدُنَّا وَلَكِنَّ أَكْثَرَهُمْ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٥٨﴾

وَكَمْ أَهْلَكْنَا مِنْ قَرْيَةٍ بَطَرَتْ مَعِيشَتَهَا  
فَتِلْكَ مَسْكِنُهُمْ لَمْ يَسْكُنْ مِنْ بَعْدِهِمْ  
إِلَّا قَلِيلًا ۗ وَكُنَّا نَحْنُ الْوَارِثِينَ ﴿٥٩﴾

وَمَا كَانَ رَبُّكَ مُهْلِكَ الْقُرَىٰ حَتَّىٰ يَبْعَثَ  
فِي أُمَّهَا رَسُولًا يَتْلُوا عَلَيْهِمُ آيَاتِنَا ۚ وَمَا  
كُنَّا مُهْلِكِي الْقُرَىٰ إِلَّا وَأَهْلُهَا ظَالِمُونَ ﴿٦٠﴾

وَمَا أَوْتَيْنَهُمْ مِّنْ شَيْءٍ فَمَتَاعُ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا  
وَزِينَتُهَا ۚ وَمَا عِنْدَ اللَّهِ خَيْرٌ وَأَبْغَىٰ ۗ أَفَلَا  
يَعْقِلُونَ ﴿٦١﴾

أَفَمَنْ وَعَدْنَاهُ وَعَدًّا حَسًّا فَهُوَ لَا يَأْتِيهِ كَمَنْ

premtim të mbarë, të cilin ai do ta gëzojë patjetër, a mund të jetë si ai që i kemi dhënë përfitim të shkurtër të jetës së kësaj bote dhe që Ditën e Kiametit do të paraqitet (për të dhënë llogari)?!

63. Ditën kur Ai do t'i thërrasë ata dhe do t'u thotë: “Ku janë ortakët e Mi që pretendonit ju?”

64. Ata për të cilët do të lëshohet me të drejtë vendimi, do të thonë: “O Zoti ynë! Këta janë ata që i kemi devijuar. I kemi devijuar ashtu siç devijua vetë. Distancohemi nga ata dhe (tani) vijnë te Ti. Këta nuk na adhuronin ne.”

65. Do t'u thuhet: “Thirrni ortakët tuaj (që kishit ngritur përballë Allahut)!” Ata do t'i thërrasin, por ata nuk do t'u përgjigjen dhe ata do të shohin ndëshkimin. Ah sikur të kishin pranuar udhëzimin!

66. Dhe ditën kur Ai do t'i thërrasë dhe do t'i pyesë: “Si u jeni përgjigjur të Dërguarve?”

67. Atëherë atë ditë atyre do t'u mjegullohen lajmet dhe ata as nuk do të pyesin dot njëri-tjetrin.

68. Për sa i përket atij që u pendua, besoi dhe bëri të mira, mundet që të jetë ndër të suksesshmit.

مَتَّعْنَاهُ مَتَاعَ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا ثُمَّ هُوَ يَوْمَ الْقِيَامَةِ مِنَ الْمُحْضَرِينَ ﴿٦١﴾

وَيَوْمَ يُأْتِيهِمْ فَيَقُولُ أَيْنَ شُرَكَائِيَ الَّذِينَ كُنْتُمْ تَزْعُمُونَ ﴿٦٢﴾

قَالَ الَّذِينَ حَقَّ عَلَيْهِمُ الْقَوْلُ رَبَّنَا هَؤُلَاءِ الَّذِينَ أَغْوَيْنَا أَغْوَيْنَاهُمْ كَمَا غَوَيْنَا تَبَرَّأْنَا إِلَيْكَ مَا كَانُوا إِيَّانَا يَعْبُدُونَ ﴿٦٣﴾

وَقِيلَ ادْعُوا شُرَكَاءَكُمْ فَدَعَوْهُمُ فَلَمْ يَسْتَجِيبُوا لَهُمْ وَرَأَوُا الْعَذَابَ لَوْ أَنَّهُمْ كَانُوا يَهْتَدُونَ ﴿٦٤﴾

وَيَوْمَ يُأْتِيهِمْ فَيَقُولُ مَاذَا أَحْبَبْتُمُ الْمُرْسَلِينَ ﴿٦٥﴾

فَعَمِيَتْ عَلَيْهِمُ الْأَنْبَاءُ يَوْمَئِذٍ فَهُمْ لَا يَتَسَاءَلُونَ ﴿٦٦﴾

فَأَمَّا مَنْ تَابَ وَآمَنَ وَعَمِلَ صَالِحًا فَعَسَىٰ أَنْ يَكُونَ مِنَ الْمُفْلِحِينَ ﴿٦٧﴾

69. Zoti yt krijon çfarë të dojë dhe zgjedh (prej saj). Ata nuk e kanë mundësinë e zgjedhjes. I pastër është Allahu nga çdo e metë dhe shumë i lartë nga gjithçka që ata e bëjnë ortak me Të.

70. Dhe Zoti yt di atë çfarë fshehin kraharorët e tyre, si dhe atë që ata zbulojnë.

71. Është Ai Allahu, nuk ka të adhurueshëm tjetër përveç Tij. E Atij është lavdia edhe në fillim, edhe në fund. Atij i përket vendimi dhe tek Ai do të ktheheni ju.

72. Thuaj: Si mendoni nëse Allahu do të zgjasë mbi ju natën pandërprerë deri në Ditën e Kiametit, cili i adhurueshëm tjetër përveç Allahut mund t'ju sjellë ndonjë dritë?! A nuk dëgjoni?!

73. Thuaj: Si mendoni nëse Allahu do të zgjasë mbi ju ditën pandërprerë deri në Ditën e Kiametit, cili i adhurueshëm tjetër përveç Allahut mund t'ju sjellë natë që ju të pushoni në të? A nuk shihni?

74. Prej mëshirës së Tij, Ai bëri për ju natën dhe ditën, që ju të pushoni në të dhe të kërkonti bekimet e Tij dhe që të falënderoni.

75. Dhe ditën kur Ai do t'i thërrasë ata dhe do t'u thotë: Ku janë ortakët e Mi që pretendonit ju?

وَرَبُّكَ يَخْلُقُ مَا يَشَاءُ وَيَخْتَارُ ۗ مَا كَانَ لَهُمُ الْخِيَرَةُ ۗ سُبْحَانَ اللَّهِ وَتَعَالَى عَمَّا يُشْرِكُونَ ﴿٦٩﴾

وَرَبُّكَ يَعْلَمُ مَا تُكِنُّ صُدُورُهُمْ وَمَا يُعْلِنُونَ ﴿٧٠﴾

وَهُوَ اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ ۗ لَهُ الْحَمْدُ فِي الْأُولَىٰ وَالْآخِرَةِ ۗ وَلَهُ الْحُكْمُ وَإِلَيْهِ تُرْجَعُونَ ﴿٧١﴾

قُلْ أَرَأَيْتُمْ إِنْ جَعَلَ اللَّهُ عَلَيْكُمُ الْآيِلَ سَرْمَدًا إِلَىٰ يَوْمِ الْقِيَامَةِ مِنْ إِلَهٍ غَيْرِ اللَّهِ يَأْتِيكُمْ بِضِيَاءٍ ۗ أَفَلَا تَسْمَعُونَ ﴿٧٢﴾

قُلْ أَرَأَيْتُمْ إِنْ جَعَلَ اللَّهُ عَلَيْكُمُ النَّهَارَ سَرْمَدًا إِلَىٰ يَوْمِ الْقِيَامَةِ مِنْ إِلَهٍ غَيْرِ اللَّهِ يَأْتِيكُمْ بِاللَّيْلِ تَسْكُونُونَ فِيهِ ۗ أَفَلَا تُبْصِرُونَ ﴿٧٣﴾

وَمِنْ رَحْمَتِهِ جَعَلَ لَكُمُ الْآيِلَ وَالنَّهَارَ لِتَسْكُنُوا فِيهِ وَ لِيَبْتَغُوا مِنْ فَضْلِهِ ۗ وَلَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ ﴿٧٤﴾

وَيَوْمَ يُنَادِيهِمْ فَيَقُولُ أَيْنَ شُرَكَائِيَ الَّذِينَ كُنْتُمْ تَزْعُمُونَ ﴿٧٥﴾



76. Ne do të nxjerrim nga një dëshmitar prej çdo populli dhe do t'u themi: Sillni argumentin tuaj! Atëherë ata do të mësojnë se e vërteta është me Allahun dhe ata do të harrojnë gjithçka që sajnin.

77. Njëmend, Karuni ishte nga populli i Musait dhe ai u rebelua kundër tij. Atij i kishim dhënë kaq shumë thesare, sa çelësat e tyre ishte vështirë t'i mbarte qoftë një grup i fuqishëm njerëzish. (Kujtoni) kur populli i tij i tha: “Mos u vetëkënaq, se Allahu nuk i do ata që bien në vetëkënaqësi.

78. Prej asaj që të ka dhënë Allahu, kërko shtëpinë e *ahiretit*, as mos harro pjesën tënde nga bota dhe bëj mirësi, ashtu siç Allahu të ka bërë mirësi, dhe mos tento të bësh ngatërresa në tokë. Pa dyshim, Allahu nuk i do ngatërrestarët.”

79. (Karuni) tha: “Kjo më është dhënë mua për shkak të një dijeje që unë zotëroj”. Por a nuk diti ai që Allahu ka shkatërruar shumë brezni përpara tij, që ishin më të fuqishëm se ai dhe më të shumtë në numër?! Fajtorët nuk do të pyeten për mëkatet e tyre (kur ndëshkohen).

80. Kështu, në (një ditë) të bukur të tij, ai doli mes popullit. Ata që donin jetën e kësaj bote thanë: “Mjerë ne! Sikur ta kishim edhe ne atë që ka Karuni! Ai qenka me shumë fat!”

وَنَزَعْنَا مِنْ كُلِّ أُمَّةٍ شَهِيدًا فَقُلْنَا هَاتُوا بُرْهَانَكُمْ فَعَلِمُوا أَنَّ الْحَقَّ لِلَّهِ وَصَلَّ عَلَيْهِمْ مَا كَانُوا يَفْتَرُونَ ﴿٧٦﴾

إِنَّ قَارُونَ كَانَ مِنْ قَوْمِ مُوسَى فَبَغَى عَلَيْهِمْ ۖ وَآتَيْنَاهُ مِنَ الْكُنُوزِ مَا إِنَّ مَفَاتِحَهُ لَتَنُوءُ بِالْعُصْبَةِ أُولَى الْقُوَّةِ إِذْ قَالَ لَهُ قَوْمُهُ لَا تَفْرَحْ إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ الْفَرِحِينَ ﴿٧٧﴾

وَاتَّبِعْ فِيمَا أَنْتَ مِنَ اللَّهِ الذَّارِ الْآخِرَةَ وَلَا تَنْسَ نَصِيْبَكَ مِنَ الدُّنْيَا وَأَحْسِنْ كَمَا أَحْسَنَ اللَّهُ إِلَيْكَ وَلَا تَبْغِ الْفَسَادَ فِي الْأَرْضِ ۗ إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ الْمُفْسِدِينَ ﴿٧٨﴾

قَالَ إِنَّمَا أُوتِيْتُهُ عَلَىٰ عِلْمٍ عِنْدِي ۗ أَوَلَمْ يَعْلَم أَنَّ اللَّهَ قَدْ أَهْلَكَ مِنْ قَبْلِهِ مِنَ الْقُرُونِ مَنْ هُوَ أَشَدُّ مِنْهُ قُوَّةً وَ أَكْثَرُ جَمْعًا ۗ وَلَا يُسْئَلُ عَنْ ذُنُوبِهِمُ الْمُجْرِمُونَ ﴿٧٩﴾

فَخَرَجَ عَلَىٰ قَوْمِهِ فِي زِينَتِهِ ۗ قَالَ الَّذِينَ يُرِيدُونَ الْحَيَاةَ الدُّنْيَا لِيَلَيْتَ لَنَا مِثْلَ مَا أُوتِيَ قَارُونُ ۗ إِنَّهُ لَذُو حَظٍّ عَظِيمٍ ﴿٨٠﴾

81. Kurse atyre që u ishte dhënë dija, thanë: “Mjerë ju! Shpërblimi i Allahut është më i mirë për atë që besoi dhe bëri të mira!” Këtë (dije) nuk e gëzon tjetërkush përveç të duruarve.

82. Atëherë Ne e fundosëm (Karunin) me gjithë shtëpinë e tij në tokë. Ai nuk kishte asnjë grup njerëzish që mund ta ndihmonin përballë Allahut dhe ai nuk pati as mundësi të hakmerrej.

83. Dhe ata që deri dje ëndërronin vendin e tij, u zgjuan duke thënë: “Mjerë (ne)! Allahu shton furnizimin për kë të dojë nga robërit e Tij dhe (edhe e) pakëson (për kë të dojë). Sikur të mos na kishte bërë Allahu mirësi neve, do të na fundoste edhe ne. Mjerë! Mohuesit nuk gëzojnë sukses!”

84. Kjo është shtëpia e *ahiretit* që Ne bëjmë për ata që nuk dëshirojnë as madhështi (të vet), e as çrregullim në tokë. Fundi (i mbarë) është për ata që kanë drojë (ndaj Allahut).

85. Ai që sjell të mirën, do të ketë (shpërblim) më të mirë se ajo. Dhe ai që sjell të keqen, (ta dijë se) atyre që bënë të këqija, do t’u jepet vetëm ajo që ata kanë punuar.

86. Pa dyshim, Ai që të obligoi Kuranin, do të të kthejë ty në vendkthim.<sup>4</sup> Thuaj: Zoti im di më së

وَقَالَ الَّذِينَ أُوتُوا الْعِلْمَ وَيُكْمُ ثَوَابِ  
اللَّهِ خَيْرٌ لِّمَنْ أَمَنَ وَعَمِلَ صَالِحًا وَلَا  
يُلْقِيهَا إِلَّا الصَّابِرُونَ ﴿٨١﴾

فَخَسَفْنَا بِهِ وَبِدَارِهِ الْأَرْضَ فَمَا كَانَ  
لَهُ مِنْ فِتَّةٍ يَنْصُرُونَهُ مِنْ دُونِ اللَّهِ  
وَمَا كَانَ مِنَ الْمُتَصَرِّينَ ﴿٨٢﴾

وَأَصْبَحَ الَّذِينَ تَمَّتْ أَمْكَانُهُ بِالْأَمْسِ  
يَقُولُونَ وَيَكَانَ اللَّهُ يَبْسُطُ الرِّزْقَ لِمَنْ  
يَشَاءُ مِنْ عِبَادِهِ وَيَقْدِرُ لَوْ لَا أَنْ مَنْ  
اللَّهُ عَلَيْنَا لَخَسَفَ بِنَا وَيُكَانَهُ لَا يُفْلِحُ  
الْكَافِرُونَ ﴿٨٣﴾

تِلْكَ الدَّارُ الْآخِرَةُ نَجَعَلَهَا لِلَّذِينَ لَا  
يُرِيدُونَ عُلُوًّا فِي الْأَرْضِ وَلَا فُسَادًا  
وَالْعَاقِبَةُ لِلْمُتَّقِينَ ﴿٨٤﴾

مَنْ جَاءَ بِالْحَسَنَةِ فَلَهُ خَيْرٌ مِنْهَا وَمَنْ  
جَاءَ بِالسَّيِّئَةِ فَلَا يُجْزَى الَّذِينَ عَمِلُوا  
السَّيِّئَاتِ إِلَّا مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿٨٥﴾

إِنَّ الَّذِي فَرَضَ عَلَيْكَ الْقُرْآنَ لَرَأْدُكَ  
إِلَى مَعَادٍ قُلْ رَبِّي أَعْلَمُ مَنْ جَاءَ

4. D.m.th. në Mekë prej ku Profeti<sup>savs</sup> u detyrua të largohej për shkak të persekutimeve të

miri atë që sjell udhëzimin, si dhe atë që është në devijim të qartë.

87. Ti nuk doje që të të jepej Libri, por (kjo) është vetëm mëshirë prej Zotit tënd. Ndaj, kurrë mos u bë ndihmës i mohuesve.

88. Ata nuk duhet të arrijnë të të ndalojnë kurrë nga (qëndrimi yt mbi) ajetet e Allahut, pasi ato të janë zbritur ty. Thirr drejt Zotit tënd dhe kurrë mos u bë prej idhujtarëve.

89. Dhe mos adhuro ndonjë të adhurueshëm tjetër bashkë me Allahun. Nuk ka të adhurueshëm tjetër përveç Atij. Çdo gjë është e vdekshme, përveç manifestimit të Tij. I Atij është vendimi dhe tek Ai do të ktheheni ju.

بِالْهُدَىٰ وَمَنْ هُوَ فِي ضَلَالٍ مُّبِينٍ ﴿٥٧﴾

وَمَا كُنْتَ تَرْجُو أَن يُلْقَىٰ إِلَيْكَ الْكِتَابُ  
إِلَّا رَحْمَةً مِّن رَّبِّكَ فَلَا تَكُونَنَّ ظَهِيرًا  
لِّلْكَافِرِينَ ﴿٥٧﴾

وَلَا يَصُدُّكَ عَنْ آيَاتِ اللَّهِ بَعْدَ إِذْ  
أُنزِلَتْ إِلَيْكَ وَادْعُ إِلَىٰ رَبِّكَ وَلَا تَكُونَنَّ  
مِنَ الْمُشْرِكِينَ ﴿٥٨﴾

وَلَا تَدْعُ مَعَ اللَّهِ إِلَهًا آخَرَ ۚ لَا إِلَهَ إِلَّا  
هُوَ ۚ كُلُّ شَيْءٍ هَالِكٌ إِلَّا وَجْهَهُ ۗ لَهُ  
الْحُكْمُ وَإِلَيْهِ تُرْجَعُونَ ﴿٥٩﴾

mekasve. Ky ajet bëri profecinë se Profeti Muhammed<sup>savs</sup> do ta çlironte Mekën. Lidhja e kësaj profecie me obligimin e Kuranit përbën vërtetësinë e fuqishme të Kuranit të Shenjtë. Pra, me fjalë të tjera Zoti i thotë Profetit – nëse ti nuk kthehesh dot në Mekë, do të ngrihet pikëpyetje mbi vërtetësinë e Kuranit. Andaj, premtimi që Allahu i bëri Profetit në mënyrë kaq të fuqishme siç tregojnë fjalët e këtij ajeti, u plotësua, dhe Profeti Muhammed<sup>savs</sup> u kthye në Mekë dhe e çliroi atë.

## Surja 29 – El-Ankebut

Kjo sure është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka shtatëdhjetë ajete.

Në këtë sure rikthehen shkurtesat *Elif.Lam.Mim.*, me të cilat fillon edhe surja El-Bekare. Ndoshta kjo nënkupton që edhe një herë do të shpalozen në një mënyrë të re disa nga temat e sures El-Bekare. Kështu që, vërejmë që duke folur për hebrejtë, surja El-Bekare tregoi që besimi nuk u bëri dot dobi atyre, derisa nuk iu nënshtruan sprovave të ndryshme. Tani, edhe në këtë kohë, pra në kohën e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, njerëzit nuk do të shpëtojnë vetëm duke pohuar besimin e tyre, por në mënyrë të pashmangshme do të kalojnë në një sërë sprovash, siç kaluan popujt e mëparshëm.

Pas kësaj, Allahu i Madhërishtëm thotë se disa njerëz përballen me sprovë nga vetë prindërit e tyre të cilët adhurojnë gjëra të tjera përballë Zotit, dhe duan që edhe fëmijët e tyre të jenë si ata. Por njeriu duhet të ketë parasysh se Allahu i Madhërishtëm e porositi të bëjë vetëm mirësi ndaj prindërve për shkak të mirësisë së tyre, por ai nuk duhet të harrojë që ai gëzon mirësinë e Allahut shumë më të madhe sesa atë të prindërve, ndaj, ai nuk duhet të pranojë mendimet e prindërve në çështjet që janë *shirk* ndaj Allahut të Madhërishtëm.

Ashtu siç në suren El-Bekare që në fillim të saj flet për hipokritët duke zbuluar sëmundjet e tyre shpirtërore, edhe kjo sure flet për ta dhe analizon në mënyra të ndryshme karakterin e tyre.

Besimtarët kalojnë në sprovë nga më të ndryshmet. Nganjëherë njerëzit me ndikim në shoqëri, i urdhërojnë t'i ndjekin ata, duke thënë: Edhe sikur të jemi në rrugë të gabuar, do t'ju marrim ne gjynahet. Të tillët natyrisht që do të ndëshkohen dyfish për shkak se devijuan vetë dhe i devijuan edhe të tjerët, por në Ditën e Gjykimit Allahu i Madhërishtëm do t'ua nxjerrë në shesh gënjeshttrat që ata thoshin mbi Allahun.

Pas kësaj, kjo sure flet për popujt e *Hazret Nuhut*<sup>as</sup>, të *Hazret Ibrahim*<sup>as</sup>, të *Hazret Lutit*<sup>as</sup>, dhe të disa Profetëve të tjerë, popujt të cilët kundërshtuan të Dërguarit e kohëve të tyre dhe u shkatërruan, duke lënë pas vetëm gërmadha. Arkeologët e kohës sonë kanë zbuluar shumë nga këta popujt dhe shumë të tjerë janë ende për t'u zbuluar. Ata pretendojnë se do të gjejnë një ditë edhe Arkën e Noes (Arkën e Nuhut)<sup>as</sup>.

Më pas vjen ajeti qendror i kësaj sureje, ajeti nr. 42, mbi të cilin është emërtuar vetë surja El-Ankebut, pra merimanga. Zoti thotë se të gjithë ata që krijojnë të adhuroshëm të tjerë përballë Allahut, shembulli i tyre është ai i merimangës që ndërton një rrjetë tepër të ndërlikuar. Kështu, edhe argumentet e tyre i ngajnë pikërisht rrjetës së merimangës në ndërlikimin e tyre, por që në fakt janë shumë të dobëta. Kurse ata që ngecin në "rrjetën" e tyre, janë kaq mendjelehtë sa janë mizat që hyjnë dhe ngecin në cergën e merimangës, duke u bërë pre e saj. Të shkretët nuk dinë se nuk ka rrjetë më të dobët sesa rrjeta e saj.

Rrjeta e merimangës, megjithatë, ka një kontradiktë në vetvete. Pështyma e merimangës ka të gjithë potencialin për të bërë fijet kaq të forta me proporcion të tillë të trashësisë dhe të peshës, që edhe me hekurin nuk e bën dot një fije të tillë, prapëseprapë, ajo destinon të jetë rrjeta më e dobët. Ky shembull me siguri i sfidon kundërshtarët e Zotit që ata le të shpërndajnë çfarëdolloj rrjete të fuqishme për të realizuar planet e tyre, fundi i tyre nuk do të jetë më shumë sesa rrjeta e merimangës, e cila, siç e thamë, në dukje është e fortë, por në realitet tejet e dobët.

Në ajetin e fundit të kësaj sureje, Allahu i Madhërishëm u jep lajmin e mirë të gjithë atyre që e kërkojnë Atë me sinqeritet, se Ai do t'i përuddhë ata në rrugën e drejtë, çfarëdo besimi të kenë ata. Realisht, të gjitha fetë e botës kanë vërtetësi të atilla, në të cilat nëse ndjekësit e tyre thellohen, ata mund të zbulojnë vërtetësinë e Islamit, duke hyrë përfundimisht në rrugën e drejtë, nëse do Allahu.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. *Elif.Lam.Mim.* (Unë jam Allahu, më i Dijshmi.)

الْمِ ②

3. A menduan njerëzit se do të lihen të pohojnë – “Ne besuam”, dhe nuk do të sprovohen?!

أَحْسَبَ النَّاسُ أَنْ يُتْرَكُوا أَنْ يَقُولُوا  
آمَنَّا وَهُمْ لَا يُفْتَنُونَ ③

4. Pa dyshim, kemi sprovuar ata që ishin para tyre. Andaj, Allahu do t'i dijë patjetër ata që thanë të vërtetën dhe do t'i dijë patjetër (edhe) gënjeshtarët.<sup>1</sup>

وَلَقَدْ فَتَنَّا الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ فَلَيَعْلَمَنَّ  
اللَّهُ الَّذِينَ صَدَقُوا وَلَيَعْلَمَنَّ الْكٰذِبِينَ ④

5. Ata që bëjnë të këqija, a menduan se do të Na parakalojnë (duke i shpëtuar ndëshkimit)?! Sa keq që gjykojnë ata!

أَمْ حَسِبَ الَّذِينَ يَعْمَلُونَ السَّيِّئَاتِ أَنْ  
يَسْقُونَنَا سَاءَ مَا يَحْكُمُونَ ⑤

6. Ai që shpreson takimin me Allahun, (për të) çasti i caktuar nga Allahu do të vijë patjetër. Ai është Gjithëdëgjuesi, i Gjithëdijshmi.

مَنْ كَانَ يَرْجُوا لِقَاءَ اللَّهِ فَإِنَّ أَجَلَ اللَّهِ  
لَآتٍ وَهُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ ⑥

1. Disa njerëz pyesin: përderisa Zoti është i Gjithëdijshëm, pse i nevojitet të vërë në provë njerëzit për të ditur se cili është i fortë dhe cili është i dobët? Pa dyshim që Zoti nuk është nevojtar për këtë gjë, por qëllimi i vërtetë i sprovës është që të zbulojë disa të vërteta të fshehta të vetë njeriut, dhe për këtë arsye, Librat e Zotit e përmendin sprovën. Zoti e sprovon njeriun jo sepse Zoti nuk ia di gjendjen, por që t'i tregojë vetë njeriut të sprovuar se çfarë të metash dhe çfarë të mirash ka ai dhe, gjithashtu, t'ua zbulojë edhe të tjerëve gjendjen e tij.

Veç kësaj, kjo gjithashtu do të thotë se Zoti do që t'i dallojë gënjeshtarët nga të vërtetët (Buhariu, Kitabut-Tefsir, Surja El-Ankebut) pasi fjala *ilm* (dije) në arabisht ka edhe kuptimin e dallimit midis dy gjërave, veçanërisht kur pasohet nga parafjala *min* (nga). Shikoni edhe 2:144 dhe 3:141. Zoti i bën besimtarët të kalojnë përmes vështirësive dhe sakrificave të mëdha dhe besimin e tyre e vë në provë të fortë. Vetëm pasi ta kalojnë përmes me sukses, vërtetohet se ata janë shërbëtorë të sinqertë të Zotit. Në këtë mënyrë ata dallohen nga hipokritët, si dhe nga ata që janë gënjeshtarë në besimin e tyre.

7. Ai që përpiqet, përpiqet për veten e tij. Sigurisht, Allahu është i Pavarur nga botët.<sup>2</sup>

وَمَنْ جَاهَدَ فَإِنَّمَا يُجَاهِدُ لِنَفْسِهِ ۗ إِنَّ اللَّهَ لَغَنِيٌّ عَنِ الْعَالَمِينَ ۝

8. Dhe ata që besuan dhe bënë të mira, Ne patjetër do t'ua largojmë të këqijat dhe do t'i shpërblejmë sipas veprave të tyre më të mira që ata kanë bërë.

وَالَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَنُكَفِّرَنَّ عَنْهُمْ سَيِّئَاتِهِمْ وَلَنَجْزِيَنَّهُمْ أَحْسَنَ الَّذِي كَانُوا يَعْمَلُونَ ۝

9. Ne e porositëm njeriun për mirësi ndaj prindërve dhe (i thamë): Nëse ata luftojnë me ty që të shoqërosh me Mua në adhurim diçka për të cilën nuk ke dijeni, mos iu bind atyre. Tek Unë do të jetë kthimi juaj, atëherë do t'ju tregoj se çfarë bënit ju.<sup>3</sup>

وَوَصَّيْنَا الْإِنْسَانَ بِوَالِدَيْهِ حُسْنًا ۚ وَإِنْ جَاهَدَاكَ لِتُشْرِكَ بِي مَا لَيْسَ لَكَ بِهِ عِلْمٌ فَلَا تُطِعْهُمَا ۗ إِلَىٰ رَبِّكَ مَرْجِعُكُمْ فَأُنَبِّئُكُمْ بِمَا كُنتُمْ تَعْمَلُونَ ۝

10. Dhe ata që besuan dhe bënë të mira, Ne patjetër do t'i shpiem te të dëlirët.

وَالَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَنُدْخِلَنَّهُمْ فِي الصَّالِحِينَ ۝

11. Prej njerëzve ka nga ata që thonë: “Besuam në Allah”. Por kur ata lëndohen në (rrugën e) Allahut, ndëshkimin e njerëzve e kujtojnë si ndëshkim të Allahut. Dhe nëse do t'u vijë ndonjë ndihmë prej Zotit tënd,

وَمِنَ النَّاسِ مَنْ يَقُولُ آمَنَّا بِاللَّهِ فَإِذَا أُوذِيَ فِي اللَّهِ جَعَلَ فِتْنَةَ النَّاسِ كَعَذَابِ اللَّهِ ۗ وَلَئِنْ جَاءَ نَصْرٌ مِّن رَّبِّكَ لَيَقُولَنَّ

2. Ky ajet që përmend fjalën *xihad* jep një përshkrim të shkurtër dhe kuptimplotë të atij që quhet *muxhahid*, pra ai që bën *xihad* ose luftëtar i vërtetë në rrugën e Zotit. Idealet e larta dhe fisnike dhe përpjekjet e vazhdueshme për t'i zbatuar porositë e Zotit janë ato që në terminologjinë islame quhen *xihad*, dhe personi që i zotëron këto ideale fisnike dhe që i përmbush ato është *muxhahid* në kuptimin e vërtetë të fjalës. Ky *xihad* është më i madh, është i përhershmi. Kurse *xihadi* me armë që quhet më i vogli, është i kushtëzuar me rrethana të caktuara. Lexoni edhe 25:53.

3. Thelbi i të gjitha mësimëve fetare është Njeshmëria e Zotit. Besnikëria e njeriut duhet të jetë në radhë të parë ndaj Krijuesit të tij. Të gjitha besnikëritë e tjera burojnë prej kësaj besnikërie dhe kësaj i nënshtrohen. Kurani i Shenjtë në një ajet tjetër ka theksuar fuqimisht besnikërinë dhe dhembshurinë ndaj prindërve (17:24), edhe në raste kur prindërit ndjekin një fe tjetër (31:16), por prapëseprapë Zoti e porosit njeriun që, në raste përplasjesh, bindja e tij ndaj Zotit duhet të jetë më e lartë sesa bindja ndaj prindërve.

do të thonë patjetër: “Ne sigurisht që jemi me ju.” A nuk e di Allahu më së miri atë që ka në zemrat e (njerëzve të të gjitha) botëve?!

12. Pa dyshim, Allahu do t’i dallojë edhe ata që besuan, dhe do t’i dallojë edhe hipokritët.

13. Ata që mohuan u thanë atyre që besuan – Ndiqni rrugën tonë, dhe ne do të mbartim gjynahet tuaja –, ndërkohë ata nuk kanë për t’i mbartur gjynahet e tyre aspak. Sigurisht, ata janë gënjeshtarë.

14. Sigurisht, ata do të mbartin barrët e tyre, dhe përveç barrëve të tyre edhe disa barrë të tjera. Ditën e Kiametit ata do të pyeten patjetër për gjithçka që trillonin.

15. Ne dërguam Nuhun te populli i tij dhe ai qëndroi mes tyre një mijë pa pesëdhjetë vjet.<sup>4</sup> Ata i zuri përmbytja kur ishin keqbërës.

16. Atëherë Ne i shpëtuan atë dhe udhëtarët e anijes dhe i bëmë shenjë për botët.

17. (Dërguam) edhe Ibrahimin; (dhe kujtoni) kur ai i tha popullit të vet: “Adhuroni Allahun dhe kini druajtje ndaj Tij. Kjo është më e mirë për ju, nëse dini.

إِنَّا كُنَّا مَعَكُمْ ۗ أَوْ لَيْسَ اللَّهُ بِأَعْلَمَ بِمَا فِي صُدُورِ الْعَالَمِينَ ﴿١١﴾

وَلَيَعْلَمَنَّ اللَّهُ الَّذِينَ آمَنُوا وَلَيَعْلَمَنَّ الْمُنَافِقِينَ ﴿١٢﴾

وَقَالَ الَّذِينَ كَفَرُوا لِلَّذِينَ آمَنُوا اتَّبِعُوا سَبِيلَنَا وَلْنَحْمِلْ خَطِيئَتَكُمْ ۗ وَمَا هُمْ بِحَامِلِينَ مِنْ خَطِيئَتِهِمْ مِنْ شَيْءٍ ۗ إِنَّهُمْ لَكَذِبُونَ ﴿١٣﴾

وَلَيَحْمِلُنَّ أَثْقَالَهُمْ وَأَثْقَالًا مَعَ أَثْقَالِهِمْ ۗ وَلَيَسَلَّنَّ يَوْمَ الْقِيَامَةِ عَمَّا كَانُوا يَفْتَرُونَ ﴿١٤﴾

وَلَقَدْ أَرْسَلْنَا نُوحًا إِلَىٰ قَوْمِهِ فَلَبِثَ فِيهِمْ أَلْفَ سَنَةٍ إِلَّا خَمْسِينَ عَامًا ۗ فَأَحَدَهُمُ الظُّلُوفَانَ وَهُمْ ظَالِمُونَ ﴿١٥﴾

فَأَنْجَيْنَاهُ وَأَصْحَابَ السَّفِينَةِ وَجَعَلْنَاهَا آيَةً لِّلْعَالَمِينَ ﴿١٦﴾

وَإِبْرَاهِيمَ إِذْ قَالَ لِقَوْمِهِ اعْبُدُوا اللَّهَ وَاتَّقُوهُ ۗ ذَلِكُمْ خَيْرٌ لَّكُمْ إِن كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ ﴿١٧﴾

4. Kjo që u tha se mosha e Hazret Nuhut<sup>as</sup> ishte 950 vjet, në fakt, i referohet moshës së Sheriatit të tij, e jo moshës së tij biologjike. Duket se mosha e Sheriatit të tij e prek edhe periudhën e profetërisë së Hazret Ibrahimit<sup>as</sup>, siç e thotë Kurani “prej grupit të tij ishte edhe Ibrahim” (37:84).



18. Njëmend, ju adhuroni idhuj duke e lënë Allahun dhe sajoni gënjeshtër. Ata që ju i adhuroni në vend të Allahut, nuk ju sigurojnë dot asnjë lloj ushqimi. Prandaj, pranë Allahut kërkoni ushqimin, Atë adhurojeni dhe Atë falënderojeni. Tek Ai do të ktheheni ju.

إِنَّمَا تَعْبُدُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ أَوْثَانًا  
وَتَخْلُقُونَ إِفْكًا ۚ إِنَّ الَّذِينَ تَعْبُدُونَ مِنْ  
دُونِ اللَّهِ لَا يَمْلِكُونَ لَكُمْ رِزْقًا فَابْتَغُوا  
عِنْدَ اللَّهِ الرِّزْقَ وَاعْبُدُوهُ وَاشْكُرُوا لَهُ  
إِنِّيهِ تُرْجَعُونَ ﴿١٨﴾

19. Nëse do ta quani gënjeshtër, kështu kanë përgënjeshtëruar shumë popuj përpara jush. Dhe i Dërguari është i ngarkuar vetëm me kumtimin e qartë të mesazhit.”

وَإِنْ تَكْذِبُوا فَعَدَبَ أُمَّةٍ مِّنْ  
قَبْلِكُمْ ۗ وَمَا عَلَى الرَّسُولِ إِلَّا الْبَلْغُ  
الْمُبِينُ ﴿١٩﴾

20. A nuk shohin sesi Allahu nis krijimin dhe e përsërit atë?! Pa dyshim, kjo për Allahun është e lehtë.

أَو لَمْ يَرَوْا كَيْفَ يُبْدِئُ اللَّهُ الْخَلْقَ  
ثُمَّ يُعِيدُهُ ۗ إِنَّ ذَلِكَ عَلَى اللَّهِ يَسِيرٌ ﴿٢٠﴾

21. Thuaju: Shëtini në tokë dhe shihni sesi Ai nis krijimin, pastaj (pikërisht) Allahu do të mundësojë krijimin e radhës.<sup>5</sup> Sigurisht, Allahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë.

قُلْ سِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَانظُرُوا كَيْفَ  
بَدَأَ الْخَلْقَ ثُمَّ اللَّهُ يُنشِئُ النَّشْأَةَ الْآخِرَةَ ۗ  
إِنَّ اللَّهَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿٢١﴾

22. Ai ndëshkon kë të dojë dhe mëshiron kë të dojë dhe tek Ai do të ktheheni.

يُعَذِّبُ مَنْ يَشَاءُ وَيَرْحَمُ مَنْ يَشَاءُ ۗ وَإِلَيْهِ  
تُقَلَّبُونَ ﴿٢٢﴾

23. Ju nuk mund ta mundni dot (Allahun) as në tokë, e as në qiell. Ju nuk keni asnjë mik dhe as ndihmës, përveç Allahut.

وَمَا أَنْتُمْ بِمُعْجِزِينَ فِي الْأَرْضِ وَلَا فِي  
السَّمَاءِ ۗ وَمَا لَكُمْ مِنْ دُونِ اللَّهِ مِنْ وَلِيٍّ  
وَلَا نَصِيرٍ ﴿٢٣﴾

5. Kjo si shprehje është përdorur në disa vende në Kuran (6:12; 12:110; 30:10; 35:45; 40:83), dhe pothuajse kudo është ndjekur nga një fjali që deklaron për shkatërrimin e një populli dhe për krijimin e një populli tjetër në vend të të parit. Në këtë kontekst, edhe ky ajet nuk i referohet vetëm Ringjalljes pas vdekjes, por edhe fenomenit të ngritjes dhe të rënies së popujve.

24. Dhe ata që mohuan shenjat e Allahut dhe takimin me Të, e kanë humbur shpresën nga mëshira Ime. Pikërisht këta do të kenë ndëshkim të dhimbshëm.

25. Atëherë përgjigjja e popullit të tij (pra, të Ibrahimit) nuk qe tjetër veçse: “Vriteni ose digjeni fare këtë (njeri)!” Atëherë Allahu e shpëtoi atë prej zjarrit. Pa dyshim, në të ka shenja për njerëzit që besojnë.

26. (Ibrahimi u) tha: Ju keni zgjedhur ca idhuj duke lënë Allahun, nga dashuria për njëri-tjetrin në jetën e kësaj bote. Më pas, Ditën e Kiametit disa prej jush do të mohojnë disa të tjerë, dhe disa prej jush do të mallkojnë disa të tjerë. Streha juaj do të jetë zjarri dhe ju nuk do të keni asnjë ndihmës.

27. Luti e besoi (Ibrahimin). (Ibrahimi) tha: “Unë po mërgoj drejt Zotit tim; pikërisht Ai është i Plotfuqishmi, i Urti.”<sup>6</sup>

28. Dhe Ne i dhuruam (Ibrahimit) Is'hakun dhe Jakubin, caktuam te pasardhësit e tij profetërinë dhe Librin (si bekim); dhe i dhamë shpërblimin e tij (edhe) në këtë botë. Pa dyshim, në *ahiret* ai do të jetë ndër të dëlirët.

6. Njeriut i duhet të lërë shumë gjëra për hir të Zotit: herë bindjet dhe traditat e tij, herë shtëpinë, herë ushqimin, herë të afërmit dhe shokët e tij, herë edhe vendin e tij. Shkurt, ai lë gjithçka që e pengon në udhëtimin e tij nga errësirat drejt dritës. Mërgimi në këtë ajet, sipas disa komentuesve, i referohet Profetit Lut<sup>as</sup>, kurse sipas disave të tjerë, Profetit Ibrahim<sup>as</sup>. Lexoni edhe 19:49.

وَالَّذِينَ كَفَرُوا بِآيَاتِ اللَّهِ وَلِقَائِهِ أُولَٰئِكَ  
يَسْأَلُونَ مِنْ رَحْمَتِي وَأُولَٰئِكَ لَهُمْ عَذَابٌ  
أَلِيمٌ ﴿٢٤﴾

فَمَا كَانَ جَوَابَ قَوْمِهِ إِلَّا أَنْ قَالُوا  
اقْتُلُوهُ أَوْ حَرِّقُوهُ فَأَنْجَاهُ اللَّهُ مِنَ النَّارِ  
إِنَّ فِي ذَٰلِكَ لَآيَاتٍ لِّقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ ﴿٢٥﴾

وَقَالَ إِنَّمَا اتَّخَذْتُمْ مِّنْ دُونِ اللَّهِ أَوْثَانًا  
مَّوَدَّةَ بَيْنِكُمْ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا ثُمَّ يَوْمَ  
الْقِيَامَةِ يَكْفُرُ بَعْضُكُم بِبَعْضٍ وَيَلْعَنُ  
بَعْضُكُم بَعْضًا وَمَأْوَاكُمُ النَّارُ وَمَا  
لَكُمْ مِّنْ نَّصِيرِينَ ﴿٢٦﴾

فَأَمَّنَ لَهُ لُوطٌ وَقَالَ إِنِّي مُهَاجِرٌ إِلَى  
رَبِّي إِنَّهُ هُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ﴿٢٧﴾

وَوَهَبْنَا لَهُ إِسْحَاقَ وَيَعْقُوبَ وَجَعَلْنَا فِي  
ذُرِّيَّتِهِ التُّبَّةَ وَالْكِتَابَ وَأَتَيْنَاهُ آجْرَهُ فِي  
الدُّنْيَا وَإِنَّهُ فِي الْآخِرَةِ لَمِنَ الصَّالِحِينَ ﴿٢٨﴾

29. (Ne dërguam) edhe Lutin. Kur ai i tha popullit të tij: “Po shkoni me shpejtësi drejt paturpësisë, aq sa asnjë nëpër botë nuk ju ka parakaluar në këtë (ligësi).

30. Vallë, a shkoni pas burrave (për epush, duke i lënë gratë) dhe rrëmbeni udhëtarët, dhe diskutoni të shëmtuarën në mbledhjet tuaja!” Atëherë, përgjigja e popullit të tij nuk qe tjetër veçse: “Na sill pra ndëshkimin e Allahut, nëse je i vërtetë!”

31. (Luti) tha: “O Zoti im! Më ndihmo kundër popullit ngatërrestar!”

32. Dhe kur i erdhën të dërguarit Tanë Ibrahimit me lajmin e mirë, i thanë: “Pa dyshim, ne do të shkatërrojmë banorët e këtij fshati (të Lutit). Banorët e tij janë keqbërës.”<sup>7</sup>

33. (Ibrahimi) tha: “Por aty jeton edhe Luti!” Ata thanë: “Ne e dimë më së miri se kush është atje. Ne patjetër që do ta shpëtojmë (Lutin) dhe familjen e tij, me përjashtim të gruas së tij, e cila është me ata që do të ngelen mbrapa.”

34. Dhe kur të dërguarit Tanë shkuan te Luti, ai u mërzi dhe

وَلَوْطًا إِذْ قَالَ لِقَوْمِهِ إِنَّكُمْ لَأْتُونَ  
الْفَاحِشَةَ ۗ مَا سَبَقَكُمْ بِهَا مِنْ أَحَدٍ مِّنَ  
الْعَالَمِينَ ﴿٢٩﴾

أَبَيْكُمْ لَأْتُونَ الرِّجَالَ وَتَقْطَعُونَ  
السَّبِيلَ ۗ وَتَأْتُونَ فِي نَادِيكُمُ الْمُنْكَرَ ۗ فَمَا  
كَانَ جَوَابَ قَوْمِهِ إِلَّا أَنْ قَالُوا إِنَّتِنَا  
بِعَذَابِ اللَّهِ إِنْ كُنْتُمْ مِنَ الصَّادِقِينَ ﴿٣٠﴾

قَالَ رَبِّ انصُرْنِي عَلَى الْقَوْمِ  
الْمُفْسِدِينَ ﴿٣١﴾

وَلَمَّا جَاءَتْ رُسُلُنَا إِبْرَاهِيمَ بِالْبُشْرَى ۖ  
قَالُوا إِنَّا مُهْلِكُوا أَهْلَ هَذِهِ الْقَرْيَةِ ۚ إِنَّ  
أَهْلَهَا كَانُوا ظَالِمِينَ ﴿٣٢﴾

قَالَ إِنَّ فِيهَا لُوطًا ۗ قَالُوا نَحْنُ أَعْلَمُ  
بِمَنْ فِيهَا ۗ لَنُنَجِّيَنَّهُ وَأَهْلَهُ إِلَّا امْرَأَتَهُ ۗ  
كَانَتْ مِنَ الْغَابِرِينَ ﴿٣٣﴾

وَلَمَّا أَنْ جَاءَتْ رُسُلُنَا لُوطًا سِئَاءَ بِهِمْ  
وَصَاقَ بِهِمْ ذُرْعًا وَقَالُوا لَا تَخَفْ وَلَا

7. Engjëjt që zbritën për të shkatërruar popullin e *Hazret Lutit*<sup>as</sup>, më parë i zbritën *Hazret Ibrahimit*<sup>as</sup>, të cilin, ndër të tjera, e njoftuan edhe për ndëshkimin në fjalë. Duke qenë një njeri tejet zemërbutë, *Hazret Ibrahimit*<sup>as</sup> iu lut shumë Allahut të Madhërishtëm që ta falte popullin e Lutit, por kishin ngelur kaq pak njerëz të mirë, sa që pasi i shpëtoi ata, Allahu e shkatërroi popullin e Lutit.

ndjeu ngushtim për shkak të tyre. Ata i thanë: Mos u frikëso e as mos u brengos. Ne do të të shpëtojmë ty dhe familjen tënde, me përjashtim të gruas sate. Ajo është me ata që do të ngelen mbrapa.

35. Ne do të zbresim mbi banorët e këtij fshati një ndëshkim prej qiellit për shkak të paturpësisë që ata bëjnë.

36. Në të Ne lamë një shenjë të qartë për njerëzit që kuptojnë.

37. Dhe (dërguam) drejt Medjenit, vëllain e tyre, Shuajbin. Ai tha: “O populli im! Adhuroni Allahun dhe shpresoni Ditën e Fundit dhe mos bëni ngatërresa në tokë si keqbërës.”

38. Ata e quajtën gënjeshtar (Shuajbin). Ata i zuri tërmeti dhe në shtëpitë e tyre mbetën të gjunjëzuar.

39. (Ne shkatërroam me tërmete) edhe adët, edhe themudët. Kjo juve ju është bërë e qartë nga (rrënojat e) shtëpive të tyre. Djalli ua zbukuroi veprat, i pengoi nga rruga (e drejtë) dhe ata ishin të vetëdijshëm (për këtë).

40. (I ndëshkuam) edhe Karunin, Faraonin e Hamanin. Atyre u kishte sjellë Musai shenjat, prapëseprapë ata ishin mendjemëdhenj në tokë, por nuk mund ta parandalonin (ndëshkimin Tonë).

تَحَزَنُ ۖ إِنَّا مَنَجُّوكَ وَأَهْلَكَ إِلَّا  
أُمَّرَأَتَكَ كَانَتْ مِنَ الْغَابِرِينَ ﴿٣٥﴾

إِنَّا مُنَزِّلُونَ عَلَىٰ أَهْلِ هَذِهِ الْقَرْيَةِ رِجْرًا  
مِّنَ السَّمَاءِ بِمَا كَانُوا يَفْسُقُونَ ﴿٣٦﴾

وَلَقَدْ تَرَكْنَا مِنْهَا آيَةً بَيِّنَةً لِّقَوْمٍ  
يَعْقِلُونَ ﴿٣٧﴾

وَإِلَىٰ مَدْيَنَ أَخَاهُمْ شُعَيْبًا ۖ فَقَالَ يٰقَوْمِ  
اعْبُدُوا اللَّهَ وَارْجُوا الْيَوْمَ الْآخِرَ وَلَا تَعْمُوا  
فِي الْأَرْضِ مُفْسِدِينَ ﴿٣٨﴾

فَكَذَّبُوهُ فَأَخَذَتْهُمُ الرَّجْفَةُ فَأَصْبَحُوا  
فِي دَارِهِمْ جُثَمِينَ ﴿٣٩﴾

وَعَادًا وَثَمُودًا ۖ وَقَدْ تَبَيَّنَ لَكُم مِّن  
مَّسْكِنِهِمْ ۖ وَزَيْنَ لَهُمُ الشَّيْطَانُ  
أَعْمَالَهُمْ فَصَدَّهُمْ عَنِ السَّبِيلِ وَكَانُوا  
مُتَّبِعِينَ ﴿٤٠﴾

وَقَارُونَ وَفِرْعَوْنَ وَهَامَانَ ۖ وَلَقَدْ  
جَاءَهُم مُّوسَىٰ بِالْبَيِّنَاتِ فَاسْتَكْبَرُوا فِي  
الْأَرْضِ وَمَا كَانُوا سَابِقِينَ ﴿٤١﴾

41. Kështu, çdokënd e kemi kapur për shkak të mëkatit të tij. Prej tyre ishin nga ata të cilëve u dërguam uragan gurësh; prej tyre ishin nga ata që i kapi krisma; prej tyre ishin nga ata që i fundosëm në tokë dhe prej tyre ishin nga ata që i mbytëm në ujë. Dhe Allahu nuk është i tillë që t'u bënte keq atyre, përkundrazi, ata vetvetes i bënin keq.<sup>8</sup>

42. Shembulli i atyre që zgjodhën miq duke lënë Allahun, është ai i merimangës; ajo bën një "shtëpi" dhe, sikur ta dinë, më e dobëta e shtëpive është pikërisht shtëpia e merimangës.<sup>9</sup>

43. Pa dyshim, Allahu di çdo gjë që ata i luten në vend të Tij. Ai është i Plotfuqishmi, i Urti.

44. Këta shembuj Ne i paraqesim për njerëzit, por nuk i kuptojnë përveç të diturve.

فَكَلَّا أَخَذْنَا بِذُنُوبِهِمْ ۖ فَمِنْهُمْ مَّنْ أَرْسَلْنَا عَلَيْهِ حَاصِبًا ۖ وَ مِنْهُمْ مَّنْ أَخَذَتْهُ الصَّيْحَةُ ۖ وَ مِنْهُمْ مَّنْ خَسَفْنَا بِهِ الْأَرْضَ ۖ وَ مِنْهُمْ مَّنْ أَنْغَرَقْنَا ۖ وَ مَا كَانَ اللَّهُ لِيُظْلِمَهُمْ وَلَكِنْ كَانُوا أَنْفُسَهُمْ يَظْلِمُونَ ﴿٤١﴾

مَثَلُ الَّذِينَ اتَّخَذُوا مِنْ دُونِ اللَّهِ أَوْلِيَاءَ كَمَثَلِ الْعَنْكَبُوتِ ۖ إِتَّخَذَتْ بَيْتًا ۖ وَإِنَّ أَوْهَنَ الْبُيُوتِ لَبَيْتُ الْعَنْكَبُوتِ ۖ لَوْ كَانُوا يَعْلَمُونَ ﴿٤٢﴾

إِنَّ اللَّهَ يَعْلَمُ مَا يَدْعُونَ مِنْ دُونِهِ مِنْ شَيْءٍ ۖ وَهُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ﴿٤٣﴾

وَ تِلْكَ الْأَمْثَالُ لَضَرِبُهَا لِلنَّاسِ ۖ وَ مَا يَعْقِلُهَا إِلَّا الْعَالِمُونَ ﴿٤٤﴾

8. Kurani ka përdorur fjalë dhe shprehje të ndryshme për dënimet që patën kundërshtarët e Profetëve të ndryshëm në kohën e tyre përkatëse. Ndëshkimi që u erdhi adëve përshkruhet si furtunë (41:17; 54:20; 69:7); ajo që i goditi themudët përshkruhet si tërmet (7:79), shpërthim (11:68; 54:32), rrufe (41:18) dhe shpërthim i fuqishëm (69:6); ajo që shkatërroi popullin e Lutit ishte si breshëri gurësh prej dheu (11:83; 15:75), shi gurësh (54:35); dhe ajo që e kapi Medjenin, pra, popullin e Shuajbit, si tërmet (7:92; 29:38), shpërthim (11:95) dhe ndëshkim i ditës së rëndë (26:190). E fundit nga të gjitha dënimet qiellore që përmenden në këtë ajet, që pushtoi Faraonin dhe ushtritë e tij të fuqishme dhe oborrtarët, Hamanin dhe Karunin, duke ua shkatërruar degët dhe rrënjët, është përshkruar me shprehjet: *Ne ... e fundosëm popullin e Faraonit* (2:51; 7:137 dhe 17:104), dhe *Ne e fundosëm me gjithë shtëpinë e tij në tokë* (28:82).

9. Lexoni shpjegimin në parathënien e sures.

45. Allahu krijoi qiejt dhe tokën me vërtetësi.<sup>10</sup> Pa dyshim, në të ka një shenjë për besimtarët.

Xhuzi 21

46. Recitohet atë që të shpallet ty nga Libri dhe fal namazin. Sigurisht, namazi ndalon nga imoraliteti dhe e pahijshmjat. Përkujtimi i Allahut është (përkujtimi) më i madh. Allahu e di atë që bëni ju.<sup>11</sup>

47. Debato me ithtarët e Librit vetëm me (argumentin) më të mirë, por jo me ata prej tyre që bëjnë të këqija. Thuajuni: Ne besuam atë që na është zbritur neve dhe atë që ju është zbritur juve; i Adhurueshmi ynë dhe i Adhurueshmi juaj është Një, dhe ne Atij i jemi dorëzuar.

خَلَقَ اللَّهُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ بِالْحَقِّ ۗ  
إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَةً لِّلْمُؤْمِنِينَ ﴿٥٠﴾

وَأَقِمِ الصَّلَاةَ ۗ إِنَّ الصَّلَاةَ تَنْهَىٰ عَنِ  
الْفَحْشَاءِ وَالْمُنْكَرِ ۗ وَلَذِكْرُ اللَّهِ أَكْبَرُ ۗ  
وَاللَّهُ يَعْلَمُ مَا تَصْنَعُونَ ﴿٥١﴾

وَلَا تُجَادِلُوا أَهْلَ الْكِتَابِ إِلَّا بِالَّتِي هِيَ  
أَحْسَنُ ۗ إِلَّا الَّذِينَ ظَلَمُوا مِنْهُمْ وَقَوْلُوا  
أَمَّا بِالَّذِي أُنزِلَ إِلَيْنَا وَأُنزِلَ إِلَيْكُمْ  
وَالهٰنَا وَالِهٰكُمْ وَاحِدٌ ۗ وَ نَحْنُ لَهُ  
مُسْلِمُونَ ﴿٥٢﴾

10. Fjalët *bil-hak* (me vërtetësi) nënkuptojnë se në krijimin e qiejve dhe të tokës ka prova të qarta të një projekti dhe qëllimi inteligjent, dhe në të gjithë trupat qiellorë, funksionon një plan i përsosur.

11. Tri gjëra janë përmendur në këtë ajet: studimi dhe predikimi i Kuranit, falja e namazit dhe përmendja e Allahut. Qëllimi i të triave është ta çlirojnë njeriun nga robëria e mëkatit dhe ta ndihmojnë atë të ngrihet moralisht dhe shpirtërisht. Kënaqësia në namaz vjen pasi të krijohet një lidhje mes robit dhe Zotit. Besimi dhe mëshira e Zotit nuk e mbulojnë njeriun, derisa ai nuk bie te pragu i Zotit, aq sa ta cilësojë veten tërësisht asgjë ose të afërt me asgjë. Kjo gjendje e tij e nënshtruar është e drejta e Zotit. Por nëse ai e arrin këtë, fiton kënaqësi aq të madhe sa që nuk mund të imagjinohet ndonjë kënaqësi më e madhe se ajo. Në këtë pozitë, shpirti i njeriut përulet skajshëm për të ngjasuar me hiçin, atëherë si një burim ai rrjedh drejt Zotit, duke u shkëputur nga të gjithë të adhurueshmit e tjerë përveç Allahut. Atëherë dashuria e Zotit bie mbi të. Gjatë këtij kontakti, që nga lart vullon dashuria e Zotit dhe nga poshtë adhurimi i robit, lind një përjetim i veçantë që quhet *salat* (namaz). Ky është ai namaz që ia shkrumbon ligësitë dhe i lë një dritë, e cila i shërben si një llambë e ndritshme në kohën e rreziqeve dhe të vështirësive gjatë rrugëtimit të tij. Ky namaz e njofton robin për të gjitha “ferrat” a pengesat që ai mund të hasë gjatë rrugës, dhe e shpëton prej tyre. Në këtë gjendje, namazi i tij funksionon siç thuhet në këtë ajet “namazi ndalon nga imoraliteti dhe e pahijshmjat.” Kështu ndodh sepse në zemrën e tij ka një llambë. Njeriu e arrin këtë pozitë vetëm pas përlësisë së përsosur dhe pas bindjes dhe nënshtrimit të përsosur. Pas kësaj, si mund t'i lindë atij mendimi për të bërë mëkat?! Ai nuk mund ta mohojë më posinë e Zotit. Shikimi i tij nuk mund të ngrihet për të parë imoralitetin. Pra, ai fiton një kënaqësi dhe lumturi kaq të madhe, që nuk përshkruhet dot me fjalë.

48. Dhe kështu Ne të zbritëm ty Librin. Pra, atyre që u kemi dhënë Librin, besojnë në të. Po kështu, edhe prej këtyre (ithtarëve të Librit) ka nga ata që besojnë në të. Përveç mohuesve askush nuk i kundërshton ajetet Tona.

49. Përpara kësaj, ti nuk lexoje ndonjë libër dhe as nuk shkruaje atë me dorën tënde të djathtë, se po të ndodhte kështu, kundërshtarët patjetër do të (të) dyshonin.<sup>12</sup>

50. E vërteta është që këto janë ajete të qarta që janë (gdhendur) në zemrat e atyre që u është dhënë dija. Përveç keqbërësve askush nuk i kundërshton ajetet Tona.<sup>13</sup>

51. Dhe ata thonë: “Pse nuk zbriti ndonjë shenjë mbi të prej Zotit të tij?” Thuaj: Shenjat janë tek Allahu, kurse unë jam vetëm një alarmues i qartë.

وَكَذَلِكَ أَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الْكِتَابَ ۖ فَالَّذِينَ  
أَتَيْنَهُمُ الْكِتَابَ يُؤْمِنُونَ بِهِ ۚ وَمِنْ هَؤُلَاءِ  
مَنْ يُؤْمِنُ بِهِ ۗ وَمَا يَجْحَدُ بِالَّذِينَ إِلَّا  
الْكُفْرُونَ ﴿٤٨﴾

وَمَا كُنْتَ تَتْلُو مِنْ قَبْلِهِ مِنْ كِتَابٍ  
وَلَا تَخْطُهُ بِيَمِينِكَ إِذَا لَارْتَابَ  
الْمُبْطِلُونَ ﴿٤٩﴾

بَلْ هُوَ آيَاتٌ بَيِّنَاتٌ فِي صُدُورِ الَّذِينَ أُوتُوا  
الْعِلْمَ ۗ وَمَا يُجْحَدُ بِالَّذِينَ إِلَّا الظَّالِمُونَ ﴿٥٠﴾

وَقَالُوا لَوْلَا أُنزِلَ عَلَيْهِ آيَاتٌ مِنْ رَبِّهِ  
قُلْ إِنَّمَا الْآيَاتُ عِنْدَ اللَّهِ ۗ وَإِنَّمَا أَنَا نَذِيرٌ  
مُبِينٌ ﴿٥١﴾

12. Një njeri si Profeti Muhammed<sup>savs</sup>, që nuk dinte as të lexonte e as të shkruante, dhe që ishte lindur në një vend dhe në një popull, që ishin të shkëputur nga çdo kontakt me qytetërimet dhe perandoritë e kohës, nuk mund të imagjinosh që ai të kishte ndonjë njohuri për Librat e mëparshëm të shpallur. Prandaj, është një mrekulli shumë e madhe kur ai i paraqet botës Kuranin e Shenjtë, Librin përfundimtar të shpallur, i cili jo vetëm që përmban gjithçka që ka vlerë të përhershme në Librat e mëparshëm, por është gjithashtu një përmbledhje e të gjitha mësimëve universale që plotësojnë nevojat morale dhe shpirtërore të njerëzimit për të gjitha kohërat. Kjo cilësi e Kuranit dhe zbritja e tij mbi Profetin Muhammed<sup>savs</sup> në këto rrethana, përbëjnë një provë të pakontestueshme se Kurani është një Libër i shpallur dhe se Profeti Muhammed<sup>savs</sup> është një Mësues prej Zotit.

13. Ndërsa ajeti i mëparshëm solli dëshmi të jashtme për të mbështetur se Kurani i Shenjtë është Fjala e shpallur e Zotit, ky ajët jep një dëshmi të brendshme duke deklaruar se për njerëzit që kanë dije, ajetet e tij do të jenë shenja shumë të mëdha drite në zemrat e tyre (ajete do të thotë *shenja*). Kjo gjithashtu do të thotë se zemrat e atyre njerëzve që i kuptojnë ajetet e Kuranit, lëshojnë dritën Hyjnore.

52. A nuk u mjafton që Ne zbritëm mbi ty Librin që u lexohet atyre?! Sigurisht, në të ka mëshirë dhe këshillë për njerëzit që besojnë.

أَو لَمْ يَكْفِهِمْ أَنَّا أَنْزَلْنَا عَلَيْكَ الْكِتَابَ  
يَتْلَى عَلَيْهِمْ ۗ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَرَحْمَةً وَذِكْرَىٰ  
لِقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ ﴿٥٢﴾

53. Thuaj: Allahu është i mjaftueshëm si Dëshmitar mes meje e juve. Ai di gjithçka që është në qiej dhe tokë. Dhe pikërisht ata që besuan gënjeshtren dhe mohuan Allahun, janë humbësit.

قُلْ كَفَىٰ بِاللَّهِ بَيِّنًا وَبَيْنَكُمْ شَهِيدًا  
يَعْلَمُ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ۗ وَالَّذِينَ  
آمَنُوا بِالْبَاطِلِ وَكَفَرُوا بِاللَّهِ ۗ أُولَٰئِكَ هُمُ  
الْخَاسِرُونَ ﴿٥٣﴾

54. Ata kërkojnë me nxitim ndëshkimin. Sikur të mos kishte ndonjë afat të caktuar, do t'u kishte ardhur ndëshkimi. Dhe ai do t'u vijë befaz, kur ata nuk do të jenë të vetëdijshëm.

وَيَسْتَعْجِلُونَكَ بِالْعَذَابِ ۗ وَلَوْلَا أَجَلٌ مُّسَمًّى  
لَجَاءَهُمُ الْعَذَابُ ۗ وَلِيَأْتِيَهُمْ بَعْتَةٌ وَهُمْ  
لَا يَشْعُرُونَ ﴿٥٤﴾

55. Dhe ata kërkojnë me nxitim ndëshkimin. Njëmend, xhehenemi do t'i rrethojë mohuesit.

يَسْتَعْجِلُونَكَ بِالْعَذَابِ ۗ وَإِنَّ جَهَنَّمَ لَمُحِيطَةٌ  
بِالْكَافِرِينَ ﴿٥٥﴾

56. Ditën kur do t'i mbulojë ndëshkimi nga sipër dhe nga poshtë këmbëve të tyre dhe Ai do t'u thotë: “Shijoni atë që bënit!”

يَوْمَ يَعْشَهُمُ الْعَذَابُ مِنْ فَوْقِهِمْ وَمِنْ  
تَحْتِ أَرْجُلِهِمْ وَيَقُولُ ذُوقُوا مَا كُنْتُمْ  
تَعْمَلُونَ ﴿٥٦﴾

57. O robërit e Mi që besuat! Toka ime, pa dyshim, është shumë e gjerë. Andaj, vetëm Mua Më adhuron.

لِعِبَادِي الَّذِينَ آمَنُوا إِنَّ أَرْضِي وَاسِعَةٌ  
فَالْيَايَ فَاَعْبُدُونِ ﴿٥٧﴾

58. Çdo shpirt do të shijojë vdekjen. Më pas, te Ne do të ktheheni.

كُلُّ نَفْسٍ ذَٰئِقَةُ الْمَوْتِ ۗ ثُمَّ إِلَيْنَا  
تُرْجَعُونَ ﴿٥٨﴾

59. Dhe ata që besuan dhe bënë të mira, Ne do t'i strehojmë në disa pallate të xhenetit, nën të cilat rrjedhin lumenj. Në to do të jetojnë

وَالَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَنُبَوِّئَنَّهُمْ  
مِّنَ الْجَنَّةِ غُرَفًا تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ



ata përgjithmonë. Sa shpërblim i mirë është ky për punëtorët;

حٰلِدِيْنَ فِيْهَا نِعْمَ اَجْرُ الْعٰمِلِيْنَ ﴿٥٩﴾

60. ata që duruan dhe (gjithnjë) mbështeten te Zoti i tyre!

الَّذِيْنَ صَبَرُوْا وَعَلَىٰ رِيبِهِمْ يَتَوَكَّلُوْنَ ﴿٦٠﴾

61. E sa shumë gjallesa ka që nuk mbartin me vete ushqimin e tyre! Allahu i ushqen edhe ato, edhe ju. Ai është Gjithëdëgjuesi, i Gjithëdijshmi.

وَكَآئِيْنَ مِنْ دَابَّةٍ لَّا تَحْمِلُ رِزْقَهَا ۗ اللَّهُ يَرْزُقُهَا وَاِيَّاكُمْ ۗ وَهُوَ السَّمِيْعُ الْعَلِيْمُ ﴿٦١﴾

62. Nëse i pyet kush i krijoi qiejt dhe tokën dhe (kush) i nënshtroi diellin dhe hënën, patjetër do të të thonë: “Allahu!” Atëherë për ku po vërtiten ata?!

وَلٰٓئِيْنَ سَاَلْتَهُمْ مَنْ خَلَقَ السَّمٰوٰتِ وَالْاَرْضَ وَسَخَّرَ الشَّمْسَ وَالْقَمَرَ لِيَقُوْلَنَّ اللّٰهُ فَاَنۢىۡ يُوَفِّكُوْنَ ﴿٦٢﴾

63. Allahu i shton të mirat kujt të dojë nga robërit e Tij dhe (edhe) ia pakëson. Sigurisht, Allahu është i Gjithëdijshëm për çdo gjë.

اللّٰهُ يَبْسُطُ الرِّزْقَ لِمَنْ يَّشَاءُ مِنْ عِبَادِهِ وَيَقْدِرُ لَهٗ ۗ اِنَّ اللّٰهَ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيْمٌ ﴿٦٣﴾

64. Dhe nëse i pyet kush zbriti ujë prej qiellit e më pas gjallëroi përmes tij tokën pas vdekjes së saj, patjetër do të të thonë: “Allahu!” Thuaj: “Lavdia është e Allahut.” Por shumica e tyre nuk kuptojnë.

وَلٰٓئِيْنَ سَاَلْتَهُمْ مَنْ نَزَّلَ مِنَ السَّمَآءِ مَآءً فَاَحْيَاۤ بِهٖ الْاَرْضَ مِنْۢ بَعْدِ مَوْتِهَا لِيَقُوْلَنَّ اللّٰهُ قُلِ الْحَمْدُ لِلّٰهِ ۗ بَلْ اَكْثَرُهُمْ لَا يَعْقِلُوْنَ ﴿٦٤﴾

65. Dhe jeta e kësaj bote nuk është gjë tjetër veçse një lojë dhe argëtim, kurse shtëpia e *ahiretit* është ajo që është jeta e vërtetë. Sikur ta dinin!

وَمَا هٰذِهِ الْحَيٰوةُ الدُّنْيَا اِلَّا لَهْوٌ وَّ لَعِبٌ ۗ وَاِنَّ الدَّارَ الْاٰخِرَةَ لَهِيَ الْحَيٰوَانُ لَوْ كَانُوْا يَعْلَمُوْنَ ﴿٦٥﴾

66. Kur udhëtojnë në anije, e lusin Allahun duke ia përkushtuar besimin vetëm Atij. E kur Ai i shpëton drejt tokës, menjëherë fillojnë të adhurojnë tjetër gjë pos Allahut;

فَاِذَا رَكِبُوْا فِى الْفُلِكِ دَعَوُا اللّٰهَ مُخْلِصِيْنَ لَهُ الدِّيْنَ ۗ فَلَمَّا نَجَّوْهُمُ اِلَى الْبَرِّ اِذَا هُمْ يُشْرِكُوْنَ ﴿٦٦﴾

67. që të bëhen mosmirënjohës ndaj asaj që Ne ua kemi dhënë dhe që të përfitojnë për një kohë të shkurtër. Së shpejti do të mësojnë.

لِيَكْفُرُوا بِمَا آتَيْنَاهُمْ<sup>١٤</sup> وَيَتَمَتَّعُوا فَسَوْفَ يَعْلَمُونَ ﴿٢١﴾

68. A nuk panë që Ne bëmë një Shtëpi të sigurt për ta, edhe pse rreth e përqark njerëzit rrëmbehen?! Atëherë, a do ta besojnë gënjeshtren dhe do ta mohojnë bekimin e Allahut?!

أَوَلَمْ يَرَوْا أَنَّا جَعَلْنَا حَرَمًا مِّنَّا وَيَخْتَفُونَ  
النَّاسِ مِنْ حَوْلِهِمْ<sup>١٥</sup> أَفَالْبَاطِلِ يُؤْمِنُونَ  
وَبِنِعْمَةِ اللَّهِ يَكْفُرُونَ ﴿٢٢﴾

69. Kush mund të jetë më keqbërës se ai që sajoi gënjeshtër mbi Allahun ose quajti gënjeshtër të vërtetën kur ajo i erdhi?! Streha e mohuesve, a nuk është në xhehenem?!

وَمَنْ أَظْلَمُ مِمَّنِ افْتَرَىٰ عَلَى اللَّهِ كَذِبًا  
أَوْ كَذَّبَ بِالْحَقِّ لَمَّا جَاءَهُ<sup>١٦</sup> أَلَيْسَ فِي جَهَنَّمَ  
مَثْوًى لِّلْكَافِرِينَ ﴿٢٣﴾

70. Dhe ata që përpiqen rreth Nesh, Ne patjetër do t'u prijme nëpër rrugët Tona. Pa dyshim, Allahu është me mirëbërësit.<sup>14</sup>

وَالَّذِينَ جَاهَدُوا فِينَا لَنَهْدِيَنَّهُمْ سُبُلَنَا<sup>١٧</sup>  
وَإِنَّ اللَّهَ لَمَعَ الْمُحْسِنِينَ ﴿٢٤﴾

14. Edhe ky ajet përdor fjalën *xihhad*. Xihhadi që paraqet Islami nuk ka lidhje me vrasjen dhe gjakderdhjen. Xihhadi është përpjekje e fuqishme dhe e vazhdueshme për të fituar pëlqimin e Zotit. Për temën e xihhadit, lexoni 25:53. Zoti bën premtim të fortë që kushdo që kërkon rrugën e Tij me sinqeritetin dhe vërtetësinë e zemrës, Ai ia tregon rrugën e njohjes së Tij. Fjalët arabe “*finā*” pra, “rreth Nesh” ose “duke qenë brenda Nesh” do të thotë që qëllimi duhet të jetë i bazuar tërësisht në sinqeritet dhe në pastërtinë e zemrës. Por ai që e kërkon Zotin thjesht për t'u tallur, privohet dhe mbetet fatzi.

### Surja 30 – Er-Rum

Surja Er-Rum është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka gjashtëdhjetë e një ajete.

Edhe kjo sure fillon me shkurtesat *Elif.Lam.Mim..* Suret që kanë këto shkurtesa, në përgjithësi mbartin temën që Allahu është më i Dijshmi për atë çfarë ka ndodhur dhe për atë që do të ndodhë në të ardhmen.

Në fund të sures paraardhëse u deklarua se Allahu me siguri është me mirëbërësit, dhe mirëbërësi më i madh ishte Profeti Muhammed<sup>savs</sup>. Prandaj, në këtë sure, atij i jepen parashikime për fitore pas fitoreje.

Parashikimi i parë flet për një përballje mes persëve idhujtarë dhe bizantinëve të krishterë (të cilët, sidoqoftë, pretendonin të ishin adhurues të një Zoti të Vetëm), përballje në të cilën idhujtarët gëzuan fitore në një territor të vogël. Nga kjo, idhujtarët mekas nxorën fallin që do të ishin pikërisht ata triumfues përfundimtarë përballë besimtarëve të Zotit të Vetëm. Kjo sure parashikoi që nuk do të ndodhte kështu dhe se bizantinët do ta rifitonin territorin e tyre të humbur dhe përfundimisht do të ishin muslimanët ata që do të gëzoheshin. Pra, kjo do të ishte një shpresë edhe për muslimanët që, në dashtë Allahu, edhe ata do ta korrnin fitoren mbi idhujtarët mekas.

Kjo profeci u bë në një kohë kur muslimanët ishin shumë të dobët dhe asnjëri prej tyre nuk mund të pretendonte ndonjë fitore, të çfarëdolloji. Në këtë situatë, profecia në fjalë nënkuptonte që muslimanët, në një të ardhme të shpejtë, do ta mbizotëronin sundimin madhështor të Kirasë idhujtar. Pikërisht kështu ndodhi. Por njerëzit vijnë ta mohojnë Qenien e Zotit, pavarësisht se shohin shenja kaq të qarta. Prandaj, u bëhet thirrje edhe një herë të reflektojnë krijimin e qiejve e të tokës, krijimin e vet trupit të tyre dhe, nëse ata do të jenë të drejtë, do të fillojnë të shohin shenjat e ekzistencës së Zotit në tokë, në qiej dhe në veten e tyre. Po kështu, kjo sure u tërheq vëmendje njerëzve të shohin gërmadhat e popujve të mëparshëm, duke thënë se edhe ata duhet të presin të njëjtin fund, nëse bëjnë një jetë të shkujdesur. Popujt e mëparshëm ishin jashtëzakonisht të fuqishëm nga ana materiale dhe kishin sunduar tokën më shumë sesa popujt që jetonin në kohën e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>. Por kur atyre u erdhën të Dërguarit e Zotit dhe ata i mohuan dhe i kundërshtuan, atëherë ranë përmbys dhe atyre iu shkatërrua krejt madhështia.

Pas kësaj, me shembuj të ndryshëm, paraqitet tema e jetës pas vdekjes. Kudo që vështroni, do të shihni shenjat e vdekjes pas jetës dhe të jetës pas vdekjes. Por mjerisht, njeriu nuk reflekton. I gjithë ky sistem nuk mund të destinohet që njeriu të lindte vetëm për jetën e kësaj bote. Përkundrazi, jeta e fundit do të jetë ajo në të cilën njeriu do të paraqitet përpara Krijuesit për t'i dhënë llogari për veprat e tij.

Edhe një herë të Dërguarit të Allahut<sup>savs</sup> i jepet porosia e durimit duke thënë: Duro, sepse premtimi i Allahut është i vërtetë dhe ata që nuk e besojnë këtë, nuk mund të të lëkundin ty. Durimi në këtë porosi nënkupton qëndrimin e tij me punëmirë dhe mosbraktisjen me asnjë kusht të tyre dhe të së vërtetës.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. *Elif.Lam.Mim.* (Unë jam Allahu, më i Dijshmi.)

الْمِ ②

3. U mundën romakët;<sup>1</sup>

عُلِبَتِ الرُّومُ ③

4. në një tokë të afërt;<sup>2</sup> dhe pas mundjes së tyre, ata patjetër do të triumfojnë;

فِي أَدْنَى الْأَرْضِ وَهُمْ مِنْ بَعْدِ عَلَيْهِمْ  
سَيَعْلَمُونَ ④

5. brenda disa vitesh.<sup>3</sup> Sundimi është i Allahut edhe më parë, edhe më pas. Atë ditë do të gëzohen edhe besimtarët (për shkak të fitores së tyre),

فِي بَضْعِ سِنِينَ ⑤ لِلَّهِ الْأَمْرُ مِنْ قَبْلُ وَمِنْ  
بَعْدٍ ⑥ وَيَوْمَئِذٍ يَفْرَحُ الْمُؤْمِنُونَ ⑦

6. me ndihmën e Allahut. Ai ndihmon kë të dojë dhe Ai është Triumfuesi, Mëshirëbërësi.

بَصَّرَ اللَّهُ ⑧ يَبْصُرُ مَنْ يَشَاءُ ⑨ وَهُوَ الْعَزِيزُ  
الرَّحِيمُ ⑩

7. (Ky është) premtimi i Allahut. Allahu nuk e shkel premtimin e Tij, por shumica e njerëzve nuk dinë.<sup>4</sup>

وَعَدَ اللَّهُ ⑪ لَا يُخْلِفُ اللَّهُ وَعْدَهُ ⑫ وَ لَكِنَّ  
أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ ⑬

1. Bëhet fjalë për romakët lindorë ose bizantinët.

2. Në Palestinë.

3. Profecitë zakonisht e kanë ndonjë pjesë të paqartë, si sprovë për ata që duan të anojnë nga shtrembësia. Në bazë të këtij ajeti, *Hazret Ebu Bekri*<sup>ra</sup> kishte vënë bast me Ebu Xhehlin që brenda tri a pesë vjetësh do të ndodhte ajo që parashikoi Kurani. Por nuk ndodhi ashtu. Atëherë, nisur nga fjalët "*bid'a sinin*", që në arabisht mund të ishin 3 – 9 vjet, Profeti Muhammed<sup>savs</sup> i tha Ebu Bekrit<sup>ra</sup> – Pse nuk i the disa vite më shumë?! (Tirmidhi, nr. 3193.)

4. Ajetet 3 – 7: "*U mundën romakët*" i referohet humbjes së bizantinëve kundër popullit të Kisrasë që ishin idhujtarë dhe që adhuronin zjarrin. Bashkë me këtë ngjarje, këto ajete bënë profeci se bizantinët brenda nëntë vitesh do ta mundnin Kisranë. Kjo profeci është një shenjë madhështore e vërtetësisë së Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, sepse tregon se vetëm i Dijshmi

8. Ata e dinë të dukshmen e jetës së kësaj bote, por janë të pavëmendshëm ndaj *ahiretit*.

يَعْلَمُونَ ظَاهِرًا مِّنَ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَهُمْ  
عَنِ الْآخِرَةِ هُمْ غَفْلُونَ ﴿٨﴾

9. A nuk reflektuan në shpirtin e tyre (që) Allahu nuk krijoi qiejt dhe tokën dhe gjithçka që gjendet mes tyre, por vetëm se me vërtetësi dhe për një afat të caktuar?! Njëmend, shumica e njerëzve janë mohues të takimit me Zotin e tyre.

أَوَلَمْ يَتَفَكَّرُوا فِي أَنفُسِهِمْ ۗ مَا خَلَقَ اللَّهُ  
السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ وَمَا بَيْنَهُمَا إِلَّا بِالْحَقِّ  
وَأَجَلٍ مُّسَمًّى ۗ وَإِنَّ كَثِيرًا مِّنَ النَّاسِ  
بِلِقَائِي رَبِّهِمْ لَكٰفِرُونَ ﴿٩﴾

10. Ata a nuk shëtiten në tokë që të shihnin si qe fundi i atyre që ishin më parë?! Ishin më të fuqishëm se këta, kishin çarë tokën dhe e kishin populluar më shumë sesa e kanë populluar këta. Atyre u erdhën të Dërguarit e tyre me shenjat e qarta. Pra, Allahu nuk u bëri keq, përkundrazi, ata i bënë keq vetvetes.

أَوَلَمْ يَسِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَيَنْظُرُوا كَيْفَ  
كَانَ عَاقِبَةُ الَّذِينَ مِن قَبْلِهِمْ ۗ كَانُوا أَشَدَّ  
مِنْهُمْ قُوَّةً وَ آثَارُوا الْأَرْضَ وَعَمَرُوهَا  
أَكْثَرَ مِمَّا عَمَرُوهَا وَجَاءَتْهُمْ رُسُلُهُمْ  
بِالْبَيِّنَاتِ ۗ فَمَا كَانَ اللَّهُ لِيَظْلِمَهُمْ وَلٰكِنْ  
كَانُوا أَنفُسَهُمْ يَظْلِمُونَ ﴿١٠﴾

11. Më pas, fundi i atyre që bënë keq ishte shumë i keq, sepse ata i qanin gënjeshtër ajetet e Allahut dhe i tallnin.

ثُمَّ كَانَ عَاقِبَةُ الَّذِينَ آسَأَوْا السُّوْآى أَن  
كٰذَبُوا بِآيَاتِ اللَّهِ وَكَانُوا بِهَا يَسْتَهْزِءُونَ ﴿١١﴾

12. Allahu e nis krijimin dhe më pas e përsërit atë. Pastaj tek Ai do të ktheheni ju.

اللَّهُ يَبْدُوْا الْخَلْقَ ثُمَّ يُعِيْدُهُ ثُمَّ إِلَيْهِ  
تُرْجَعُونَ ﴿١٢﴾

13. Ditën kur do të ngrihet Ora, do të dëshpërohen fajtorët.

وَيَوْمَ تَقُومُ السَّاعَةُ يُبٰلِسُ الْمُجْرِمُونَ ﴿١٣﴾

i së padukshmes ia dha këtë lajm. Po këto ajete përfundimisht parashikojnë edhe fitoren e muslimanëve mbi idhujtarët mekas, e cila gjithashtu u përmbush në mënyrë madhështore. Edhe kjo ndodhi brenda pak vitesh, pra, ditën e betejës së Bedrit.

14. Dhe nuk do të ketë asnjë ndërmjetësues nga ortakët e tyre, madje ata (vetë) do t'i mohojnë ortakët e tyre.

وَلَمْ يَكُنْ لَهُمْ مِنْ شُرَكَائِهِمْ شُفَعَاءٌ  
وَكَانُوا بِشُرَكَائِهِمْ كُفْرِينَ ﴿١٤﴾

15. Ditën kur do të ngrihet Ora, atë ditë ata do të ndahen.

وَيَوْمَ تَقُومُ السَّاعَةُ يُنْفِرُونَ ﴿١٥﴾

16. Atëherë ata që besuan dhe bënë të mira, do të gëzohen në një kopsht.

فَأَمَّا الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ فَهُمْ  
فِي رَوْضَةٍ يُحْبَرُونَ ﴿١٦﴾

17. Kurse ata që mohuan dhe i quajtën gënjeshtër ajetet Tona si dhe takimin e *ahiretit*, do të paraqiten në ndëshkim.

وَأَمَّا الَّذِينَ كَفَرُوا وَكَذَّبُوا بِآيَاتِنَا وَإِلْقَاءِ  
الْآخِرَةِ فَأُولَئِكَ فِي الْعَذَابِ مُحْضَرُونَ ﴿١٧﴾

18. Pra, i Shenjtë është Allahu edhe kur ngryseni, edhe kur gdhieni.

فَسَبَّحَنَ اللَّهُ حِينَ تُمْسُونَ وَحِينَ  
تُصْبِحُونَ ﴿١٨﴾

19. E Atij është lavdia në qiej e tokë, edhe gjatë natës, edhe kur kaloni drekën.

وَلَهُ الْحَمْدُ فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَعَشِيًّا  
وَحِينَ تَظْهَرُونَ ﴿١٩﴾

20. Ai nxjerr të gjallin prej të vdekurit dhe nxjerr të vdekurin prej të gjallit dhe Ai i jep jetë tokës pas vdekjes së saj. Ja, kështu do të nxirreni edhe ju.

يُخْرِجُ الْحَيَّ مِنَ الْمَيِّتِ وَيُخْرِجُ الْمَيِّتَ  
مِنَ الْحَيِّ وَيُحْيِي الْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا  
﴿٢٠﴾ وَكَذَلِكَ تُخْرَجُونَ ﴿٢٠﴾

21. Dhe prej shenjave të Tij është që Ai ju krijoi prej dheu, dhe më pas papritmas jeni përhapur si njerëz.

وَمِنَ آيَاتِهِ أَنْ خَلَقَكُمْ مِنْ تُرَابٍ ثُمَّ إِذَا  
أَنْتُمْ بَشَرٌ تَتَشَرُّونَ ﴿٢١﴾

22. Dhe prej shenjave të Tij është që Ai krijoi bashkëshortët tuaj nga soji juaj, që ju të qetësoheni pranë

وَمِنَ آيَاتِهِ أَنْ خَلَقَ لَكُمْ مِنْ أَنْفُسِكُمْ  
أَزْوَاجًا لِيَسْكُنُوا إِلَيْهَا وَجَعَلَ بَيْنَكُمْ

tyre dhe vuri mes jush dashuri dhe mëshirë. Pa dyshim, në këtë ka shenja për njerëzit që meditojnë.<sup>5</sup>

23. Dhe prej shenjave të Tij janë (edhe) krijimi i qiejve dhe i tokës dhe ndryshimi i gjuhëve dhe i ngjyrave tuaja. Pa dyshim, në këtë ka shenja për të diturit.<sup>6</sup>

24. Dhe prej shenjave të Tij janë (edhe) gjumi juaj gjatë natës e ditës dhe kërkimi juaj për bekimin e Tij. Sigurisht, në këtë ka shenja për njerëzit që degjojnë.

25. Dhe prej shenjave të Tij është që Ai ju tregon vetëtimën duke shkaktuar (tek ju) frikë e shpresë, zbret prej qiellit ujë dhe përmes tij i jep jetë tokës pas vdekjes së saj. Sigurisht, në këtë ka shenja për njerëzit që kuptojnë.

26. Dhe prej shenjave të Tij është që qielli dhe toka po qëndrojnë me urdhrin e Tij. Pastaj, kur Ai do t'ju bëjë thirrje prej tokës, ju papritmas do të nxirreni.

مَوَدَّةً وَرَحْمَةً ۖ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِّقَوْمٍ  
يَتَفَكَّرُونَ ﴿٣١﴾

وَمِنْ آيَاتِهِ خَلْقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ  
وَإِخْتِلَافَ أَلْسِنَتِكُمْ وَالْوَأْنِكُمْ ۗ إِنَّ فِي  
ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِّلْعَالَمِينَ ﴿٣٢﴾

وَمِنْ آيَاتِهِ مَنَامُكُمْ بِاللَّيْلِ وَالنَّهَارِ  
وَإِتِّبَاعًا وَكُفْمٌ مِّنْ فَضْلِهِ ۗ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ  
لِّقَوْمٍ يُسْمَعُونَ ﴿٣٣﴾

وَمِنْ آيَاتِهِ يُرِيكُمُ الْبَرْقَ خَوْفًا وَطَمَعًا  
وَ يُنَزِّلُ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَيُخْجِي بِهِ الْأَرْضَ  
بَعْدَ مَوْتِهَا ۗ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِّقَوْمٍ  
يَعْقِلُونَ ﴿٣٤﴾

وَمِنْ آيَاتِهِ أَنْ تَقُومَ السَّمَاءُ وَالْأَرْضُ  
بِأَمْرِهِ ۗ ثُمَّ إِذَا دَعَاكُم دَعْوَةً مِّنَ  
الْأَرْضِ ۗ إِذَا أَنْتُمْ تَخْرُجُونَ ﴿٣٥﴾

5. Dashuria mes burrit dhe gruas sjell riprodhimin dhe vazhdimësinë e jetës njerëzore në tokë. Kjo tregon një projekt dhe qëllim në krijimin e njerëzimit, duke vërtetuar edhe ekzistencën e Projektuesit dhe të faktit se ka edhe një botë tjetër më të plotë, pas jetës së shkurtër të kësaj bote.

6. Progresi njerëzor është i lidhur ngushtë edhe me diversitetin e gjuhëve dhe të ngjyrave. Në fillim kishte një gjuhë që ishte gjuhë e shpallur. Më pas, njerëzit u shpërndanë nëpër vise të ndryshme dhe, bashkë me ndryshime të tjera, u ndryshuan edhe gjuhët. Kjo shumëllojshmëri shënjon përsëri një dizajn dhe një projektues. Nën larminë e gjuhëve dhe të ngjyrave që ka rezultuar në shumëllojshmëri qytetërimesh dhe kulturash, fshihet një unitet — uniteti i njerëzimit. Kjo njëshmëri e njerëzimit çon në përfundimin e pashmangshëm të Njëshmërisë së Krijuesit të tij. Ky ajet na tërheq vëmendjen kaq fuqishëm për studimin e gjuhëve, sa që këtë e quan një bazë të njohjes së Zotit. Në këtë mënyrë, Kurani i Shenjtë na nxit shumë për studimin e gjuhësisë krahasuese.

27. I Atij është kushdo që është në qiej dhe tokë. Që të gjithë Atij i janë nënshtruar.<sup>7</sup>

وَلَهُ مَنْ فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ كُلٌّ لَهُ قَانِتُونَ ﴿٧﴾

28. Është Ai që nis krijimin, e më pas, e përsërit atë dhe kjo është shumë e lehtë për Të. Atij i përket shembulli më i lartë në qiej e tokë. Dhe Ai është Mbizotëruesi, i Urti.

وَهُوَ الَّذِي بَدَأَ الْخَلْقَ ثُمَّ يُعِيدُهُ وَهُوَ أَهْوَنُ عَلَيْهِ ۗ وَلَهُ الْمَثَلُ الْأَعْلَىٰ فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ۗ وَهُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ﴿٨﴾

29. Ai ju jep një shembull nga vetja juaj. A mundet që ata të cilët janë nën zotërimin tuaj, të bëhen ortakë në atë që Ne ju kemi dhënë juve, që ju të bëheni të barabartë (me ta) dhe të keni frikë prej tyre, njësoj si frika juaj nga njerëzit (që janë të shtresës) suaj?! Ne kështu i shpjegojmë shenjat për njerëzit që kuptojnë.<sup>8</sup>

صَرََبَ لَكُمْ مَثَلًا مِّنْ أَنْفُسِكُمْ ۗ هَلْ لَّكُمْ مِّنْ مَا مَلَكَتْ أَيْمَانُكُمْ مِّنْ شُرَكَاءَ فِي مَا رَزَقْنَاكُمْ فَأَنْتُمْ فِيهِ سَوَاءٌ تَخَافُونَهُمْ كَخِيفَتِكُمْ أَنْفُسَكُمْ ۗ كَذَلِكَ نَفْصَلُ الْآيَاتِ لِقَوْمٍ يُعْقِلُونَ ﴿٩﴾

30. E vërteta është që ata që bënë të këqija, ndoqën dëshirat e tyre pa pasur dije. Atëherë, kush mund ta udhëzojë atë që Allahu e ka devijuar?! Të tillët nuk do të kenë asnjë ndihmës.

بَلِ اتَّبَعَ الَّذِينَ ظَلَمُوا أَهْوَاءَهُمْ بِغَيْرِ عِلْمٍ ۚ فَمَنْ يَهْدِي مَنْ أَضَلَّ اللَّهُ ۗ وَمَا لَهُمْ مِّنْ نَّصِيرِينَ ﴿١٠﴾

31. Andaj, përqendro vëmendjen tënde për fenë (e Allahut) duke qenë tërësisht i anuar (nga Ai). (Ndiq) natyrën e Allahut në të cilën Ai i

فَأَقِمْ وَجْهَكَ لِلدِّينِ حَنِيفًا ۗ فِطْرَتَ اللَّهِ الَّتِي فَطَرَ النَّاسَ عَلَيْهَا ۗ لَا تَبْدِيلَ لِخَلْقِ

7. Ka miliarda trupa qiellorë, por megjithatë ata nuk përplasen për ta prishur krijimin. Aq i përsosur është ligji dhe rendi që sundon universin! Ky është një nga kuptimet e fjalëve: “Që të gjithë Atij i janë nënshtruar”. Lexoni edhe 13:16; 64:2.

8. Në ajetet e mëparshme, pasi dha shenja të ndryshme të ekzistencës e të Njeshmërisë së Tij, në këtë ajet, Allahu i Madhërishëm u drejtohet njerëzve dhe thotë: Shërbyesit tuaj ju nuk i bëni ortakë të barabartë me ju, dhe as nuk u frikësoheni atyre, siç u druheni ortakëve. Atëherë si mund të mendoni që krijesat të jenë bashkëpuntorë në punët e Allahut?!



krijoi njerëzit.<sup>9</sup> Nuk ka ndryshim në krijimin e Allahut. Kjo është feja e qëndrueshme, por shumica e njerëzve nuk dinë.<sup>10</sup>

32. (Përqendroni vëmendjen tuaj për fenë e Allahut) duke qenë të përkulur gjithmonë tek Ai, kini drojë ndaj Tij, falni namazin dhe mos u bëni nga idhujtarët.

33. (Pra, mos u bëni) nga ata që e përçanë fenë e tyre dhe u ndanë nëpër grupe; çdo grup mburret për atë që ka.

34. Kur njerëzit i prek dhimbja, lusin Zotin e tyre duke u përkulur përpara Tij. E kur Ai i bën të shijojnë një (copë) mëshire, disa prej tyre papritmas fillojnë t'i atribuojnë ortakë Zotit të tyre;

اللَّهُ ۙ ذَٰلِكَ الدِّينَ الْقَيِّمُ ۗ وَلَٰكِنَّا أَكْثَرُ  
التَّٰسِ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٣١﴾

مُنْبِئِينَ إِلَيْهِ وَاتَّقُوهُ وَآقِمُوا الصَّلَاةَ  
وَلَا تَكُونُوا مِنَ الْمُشْرِكِينَ ﴿٣٢﴾

مِنَ الدِّينِ فَفَرَقُوا دِينَهُمْ وَكَانُوا شِيْعًا ۗ كُلُّ  
حَرْبٍ بِمَا لَدَيْهِمْ فَرِحُونَ ﴿٣٣﴾

وَإِذَا مَسَّ النَّاسَ ضُرٌّ دَعَا رَبَّهُمْ  
مُنْبِئِينَ إِلَيْهِ ثُمَّ إِذَا آذَقَهُمْ مِنْهُ رَحْمَةً  
إِذَا فَرِيقٌ مِنْهُمْ بِرَبِّهِمْ يُشْرِكُونَ ﴿٣٤﴾

9. Kjo do të thotë se Allahu i Madhërihëm krijoi njerëzit mbi natyrën e pastër dhe kjo është feja e çdo njeriu në të cilën ai lind. Më vonë, për shkak të ndikimeve të ndryshme, njeriu devijon rrugën. Pra, ky ajete tregon se fëmijët që lindin qoftë te të krishterët, qoftë te hebrenjtë apo te hindutë etj., lindin të pastër e të pafajshëm. I Dërguari i Allahut<sup>saws</sup> tha: “Çdo fëmijë lind me natyrën e pastër, por prindërt e tij e bëjnë jude, të krishterë, adhurues të zjarrit etj..” (Buhari, nr. 4775).

10. Feja që ka më të saktë njohjen ndaj Zotit dhe më të bukur adhurimin ndaj Tij është Islami dhe Islamin Zoti e ka lënë në natyrën e njeriut. Zoti e krijoi njeriun mbi Islamin dhe për Islamin. Kjo është feja e qëndrueshme. Kjo do të thotë se Zoti deshi që njeriu me të gjitha aftësitë e tij, ta adhurojë Atë, t'i bindet Atij dhe ta dojë Atë. Pikërisht për këtë arsye, Ai Zot që është i Plotfuqishëm dhe Bujar, njeriut i dhuroi të gjitha aftësitë në përputhje me Islamin. Edhe të krishterët, për shembull, do të praninin se aty ku nuk është propaganduar Triniteti, Zoti do t'u kërkojë llogari njerëzve për besimin në Njëshmërinë e Zotit e jo për Trinitetin. Pra, besimi në Një Zot është në natyrën e njeriut, dhe ky është Islami. Po kështu, ky ajete tregon se muslimani është porositur të ndjekë të dyja ligjësitë, edhe Librin e shenjtë (Sheriatin) që ka ligje, edhe “librin” e natyrës që është vepër e Zotit, dhe të mos nxitohet për të marrë një vendim të prerë për Librin e shenjtë, pa pasur një dëshmi edhe nga libri i natyrës. Kështu që, muslimani i përsosur është ai që i ndjek të dy “librat” dhe që sheh me të dy sytë. Muslimani i tillë gjithmonë do të jetë në rrugën e drejtë dhe askush nuk mund ta devijojë dot atë.

35. që ta mohojnë atë që Ne ua kemi dhënë. Mirë, përfitoni përkohësisht! Së shpejti do të mësoni!

لِيَكْفُرُوا بِمَا آتَيْنَاهُمْ<sup>ط</sup> فَتَمَتَّعُوا<sup>قنفة</sup> فَسَوْفَ تَعْلَمُونَ ﴿٣٥﴾

36. A u kemi zbritur Ne ndonjë argument, që u flet atyre për atë që ata e bëjnë ortak me Të?!

أَمْ أَنْزَلْنَا عَلَيْهِمْ سُلْطَانًا فَهَوَ يَتَكَلَّمُ بِمَا كَانُوا بِهِ يُشْرِكُونَ ﴿٣٦﴾

37. Kur i bëjmë njerëzit të shijojnë mëshirë, ata mburren me të, dhe kur i godet ndonjë e keqe për shkak të asaj që vetë duart e tyre e kanë çuar përpara, papritmas dëshpërohen.

وَإِذَا أَذَقْنَا النَّاسَ رَحْمَةً فَرِحُوا بِهَا<sup>ط</sup> وَإِن تُصِبَّهُمْ سَيِّئَةٌ<sup>حجة</sup> بِمَا قَدَّمَتْ أَيْدِيهِمْ إِذَا هُمْ يَقْنَطُونَ ﴿٣٧﴾

38. A nuk panë që Allahu i shton të mira kujt të dojë dhe (edhe) ia pakëson?! Sigurisht, në këtë ka shenja për njerëzit që besojnë.

أَوَلَمْ يَرَوْا أَنَّ اللَّهَ يَبْسُطُ الرِّزْقَ لِمَن يَشَاءُ وَيَقْدِرُ<sup>ط</sup> إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِّقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ ﴿٣٨﴾

39. Andaj, jepi të drejtën të afërmit, nevojtarit dhe udhëtarit. Kjo është më e mirë për ata që shpresojnë pëlqimin e Allahut. Pikërisht këta janë të suksesshmit.<sup>11</sup>

فَاتِذَا الْقُرْبَىٰ حَقَّهُ وَالْمِسْكِينَ وَابْنَ السَّبِيلِ<sup>ط</sup> ذَلِكَ خَيْرٌ لِّلَّذِينَ يُرِيدُونَ وَجْهَ اللَّهِ وَأُولَٰئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ ﴿٣٩﴾

40. Ajo që lëshoni si kamatë që t'ju shtohet me pasuritë e njerëzve, ajo nuk shtohet tek Allahu. Dhe ajo që jepni si zekat duke dashur pëlqimin e Allahut, (dijeni) se të tillët e shtojnë (pasurinë).<sup>12</sup>

النَّاسَ فَلَا يَرِيئُوا عِنْدَ اللَّهِ<sup>ج</sup> وَمَا آتَيْتُم مِّن زَكَاةٍ تُرِيدُونَ وَجْهَ اللَّهِ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْمُضْعِفُونَ ﴿٤٠﴾

11. Fjalët “jepi të drejtën” nënkuptojnë një parim thelbësor, që ndihma monetare që njerëzit e pasur u japin vëllezërve të tyre më të varfër në formën e zekatit, të bamirësisë ose të dhuratës, është e drejta e atyre që janë në nevojë, sepse edhe ata japin një kontribut të konsiderueshëm në prodhimin e pasurisë të të pasurve me punën e tyre (51: 20). Kudo që Kurani i urdhëron besimtarët t’u japin ndihmë monetare etj., u nevojtarëve dhe të varfërve, në arabisht ka përdorur foljen *āti* dhe jo *i’ti*. E para ka kuptimin e dhurimit, kurse e dyta më shumë atë të dhënies si ndihmë. Kështu, Kurani i mëson njeriut të respektojë edhe dinjitetin e të varfrit, gjithashtu të frenojë veten nga mburrja dhe të synojë vetëm pëlqimin e Allahut.

12. Ajeti tregon kontrastin midis zekatit dhe kamatës, midis sistemit të vendosur nga Zoti dhe

41. Allahu është Ai që ju krijoi, më pas ju dha të mira, më pas ju jep vdekje, më pas ju ringjall. A ka ndonjë nga idhujt tuaj që mund të bëjë diçka nga këto? I Shenjtë është Ai dhe shumë i lartë nga ajo që ata e bëjnë ortak me Të.

اللَّهُ الَّذِي خَلَقَكُمْ ثُمَّ رَزَقَكُمْ ثُمَّ يُمِيتُكُمْ  
ثُمَّ يُحْيِيكُمْ هَلْ مِنْ شُرَكَائِكُمْ مَنْ يَفْعَلُ  
مِنْ ذُرِّيَّتِكُمْ مِنْ شَيْءٍ سُبْحٰنَهُ وَتَعَالَىٰ عَمَّا  
يُشْرِكُونَ ﴿٤١﴾

42. Trazira është shfaqur në tokë e (në) det për shkak të asaj që punuan duart e njerëzve;<sup>13</sup> që Ai t'i bëjë të shijojnë një pjesë të asaj që ata bënë, se ndoshta do të tërhiqen.

ظَهَرَ الْفَسَادُ فِي الْبَرِّ وَالْبَحْرِ بِمَا كَسَبَتْ  
أَيْدِي النَّاسِ لِيذِيقَهُمْ بَعْضَ الَّذِي عَمِلُوا  
لَعَلَّهُمْ يَرْجِعُونَ ﴿٤٢﴾

43. Thuaj: Shëtini në tokë dhe shikoni se si qe fundi i atyre që ishin më përpara. Shumica prej tyre ishin idhujtarë.

قُلْ سِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَانظُرُوا كَيْفَ  
كَانَ عَاقِبَةُ الَّذِينَ مِنْ قَبْلُ كَانُوا  
أَكْثَرَهُمْ مُّشْرِكِينَ ﴿٤٣﴾

44. Andaj, përqendro vëmendjen tënde në fenë e qëndrueshme përpara se të vijë prej Allahut dita që nuk ka kthim pas. Atë ditë ata do të ndahen.

فَاقِمِ وَجْهَكَ لِلدِّينِ الْقَيِّمِ مِنْ قَبْلِ  
أَنْ يَأْتِيَ يَوْمٌ لَا مَرَدَّ لَهُ مِنَ اللَّهِ يَوْمَئِذٍ  
يَصَّدَعُونَ ﴿٤٤﴾

45. Ai që mohoi, mohimi i tij do të bjerë kundër tij dhe ata që bënë të mira, bëjnë përgatitje për dobinë e tyre.

مَنْ كَفَرَ فَعَلَيْهِ كُفْرُهُ ۗ وَمَنْ عَمِلْ صَالِحًا  
فَلَا نَفْسِهِمْ يَمْهُدُونَ ﴿٤٥﴾

sistemit të krijuar nga njeriu. Ndërsa zekati synon të përmirësojë gjendjen e mjerueshme të të varfërve, duke ruajtur njëherësh edhe dinjitetin dhe respektin e tyre, fajdeja jo vetëm që nuk përmirëson gjendjen ekonomike të të varfërve, por në fakt tenton të bëjë të pasurit edhe më të pasur dhe të varfrit edhe më të varfër.

13. Udhëheqësi dhe Prijësi ynë, i Dërguari i Allahut, Profeti Muhammed<sup>savs</sup> kishte ardhur në një kohë, kur bota ishte prishur në të gjitha aspektet, siç Allahu i Madhërisëm thotë: “Edhe toka ishte prishur, po ashtu edhe detet ishin prishur.” Kjo do të thotë se ishin degjeneruar edhe ata që quheshin popujt e Librit, edhe të tjerët që nuk kishin marrë ujin e shpalljes Hyjnore. Pra, synimi i Kuranit të Shenjtë ishte të ringjallte “të vdekurit”, siç e thotë edhe në ajetet 49 – 51 të kësaj sureje.

46. Që Ai t'i shpërblejë prej bekimit të Tij ata që besuan dhe bënë të mira. Pa dyshim, Ai nuk i do mohuesit.

لِيَجْزِيَ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ مِنْ فَضْلِهِ ۗ إِنَّهُ لَا يُحِبُّ الْكَافِرِينَ ﴿٤٦﴾

47. Dhe prej shenjave të Tij është (edhe kjo) që Ai dërgon erërat si lajmëmire, që t'ju bëjë të shijoni diçka nga mëshira e Tij, që anijet të lundrojnë me urdhrin e Tij, që ju të kërkoni bekimin e Tij dhe që të falënderoni.<sup>14</sup>

وَمِنْ آيَاتِهِ أَنْ يُرْسِلَ الرِّيحَ مُبَشِّرَاتٍ وَ لِيَذِيقَكُمْ مِنْ رَحْمَتِهِ وَلِتَجْرِيَ الْفُلُكُ بِأَمْرِهِ وَلِتَبْتَغُوا مِنْ فَضْلِهِ وَلَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ ﴿٤٧﴾

48. Edhe para teje kemi dërguar të dërguar drejt popujve të tyre. Ata u erdhën me shenjat e qarta. Atëherë Ne u hakmorëm me ata që bënë krime. E kemi pasur për detyrë t'i ndihmonim besimtarët.

وَلَقَدْ أَرْسَلْنَا مِنْ قَبْلِكَ رُسُلًا إِلَى قَوْمِهِمْ فَجَاءَهُمْ بِالْبَيِّنَاتِ فَأَنْتَقَمْنَا مِنَ الَّذِينَ أَجْرَمُوا ۗ وَكَانَ حَقًّا عَلَيْنَا نَصْرَ الْمُؤْمِنِينَ ﴿٤٨﴾

49. Allahu është Ai që dërgon erërat dhe ato mbartin re, të cilat Ai i përhap në qiell si të dojë dhe i shpërndan në pjesë të ndryshme dhe ti sheh shiun që del përmes tyre. Kur Ai ua çon këtë (bekim) kujt të dojë prej robërve të Tij, ata sakaq gëzohen.

اللَّهُ الَّذِي يُرْسِلُ الرِّيحَ فَتُحْمَلُ السَّحَابَ فَيَبْسُطُهُ فِي السَّمَاءِ كَيْفَ يَشَاءُ وَيَجْعَلُهُ كِسْفًا فَيَنزِلُ الْوَدْقَ يَخْرُجُ مِنْ خِلَالِهِ ۚ فَإِذَا أَصَابَ بِهِ مَنْ يَشَاءُ مِنْ عِبَادِهِ إِذَا هُمْ يَسْتَبْشِرُونَ ﴿٤٩﴾

50. Ndonëse përpara se t'u zbritej (shiu), ata kishin mbetur të pashpresë për ardhjen e tij.<sup>15</sup>

وَإِنْ كَانُوا مِنْ قَبْلِ أَنْ يُنْزَلَ عَلَيْهِمْ مِنْ قَبْلِهِ كَمُبَلِّسِينَ ﴿٥٠﴾

14. Këto fjalë tregojnë për një ligj Hyjnor që funksionon njësoj, si në botën lëndore, ashtu edhe në botën shpirtërore. Sikundër erërat i paraprijnë shiut, duke paralajmëruar ardhjen e tij, në mënyrë të ngjashme, para ardhjes së një Profeti të Zotit, krijohen kushte që janë të favorshme për përhapjen e mësimëve të tij, dhe fillojnë të shfaqen njerëz të mirë dhe të drejtë që përgatisin terrenin dhe që “drejtojnë shtigjet për te Profeti.”

15. Për këtë kuptim të fjalës فَيَلِيهِ shikoni fjalorët El-Munxhid dhe El-Mu'xhemul-Vesit, ku thuhet: - أفئبل-، أنى، أفئبل-، فئبل يفئبل فئبلا: أنى، أفئبل-، pra, *erdhi, doli përpara*.

51. Pra, shiko ndikimet e mëshirës së Allahut, (se) si Ai i jep jetë tokës pas vdekjes së saj. Po Ai është Gjallëruesi i të vdekurve dhe Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë.<sup>16</sup>

52. Dhe nëse Ne dërgojmë një erë, (për shkak të së cilës) ata i shohin të zverdhura (të korrat), pas kësaj ata patjetër bëhen mosmirënjohës.

53. Ti nuk i bën dot të vdekurit të dëgjojnë dhe as nuk mund t'i bësh dot shurdhët ta dëgjojnë thirrjen (tënde), kur ata ikin duke e kthyer shpinën.

54. Dhe ti as nuk mund t'i udhëzosh të verbrit pas devijimit të tyre. Ti mund të bësh të dëgjojnë vetëm ata që besojnë në shenjat Tona dhe pikërisht ata janë të nënshtruar.<sup>17</sup>

55. Allahu është Ai që ju krijoi prej një (gjendje) dobësie dhe pas dobësisë caktoi forcë, pas forcës caktoi dobësi e pleqëri. Ai krijon çfarë të dojë. Ai është i Gjithëdijshmi, i Plotfuqishmi.

56. Ditën kur do të vendoset Ora, fajtorët do të betohen (që) ata nuk qëndruan (në tokë) përveçse një orë.

فَانظُرْ إِلَىٰ آثِرِ رَحْمَتِ اللَّهِ كَيْفَ يُحْيِي  
الْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا ۗ إِنَّ ذَٰلِكَ لَمُحْيِ  
الْمَوْتَىٰ ۗ وَهُوَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿٥١﴾

وَلَيْنَ أَرْسَلْنَا رِيحًا فَرَأَوْهُ مُصْفَرًّا  
لَتَطَّلُوا مِنْ بَعْدِهِ يُكْفَرُونَ ﴿٥٢﴾

فَإِنَّكَ لَا تَسْمَعُ الْكَلِمَةَ وَلَا تَسْمَعُ الضَّمَّةَ  
الدُّعَاءَ إِذَا وَلَّوْا مُدْبِرِينَ ﴿٥٣﴾

وَمَا أَنْتَ بِهَادٍ الْعُمَىٰ عَنْ صَلَاتِهِمْ ۗ إِنَّ  
تَسْمَعُ إِلَّا مَنْ يُؤْمِنُ بِآيَاتِنَا فَهُمْ  
مُسْلِمُونَ ﴿٥٤﴾

اللَّهُ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ ضَعْفٍ ثُمَّ جَعَلَ  
مِنْ بَعْدِ ضَعْفٍ قُوَّةً ثُمَّ جَعَلَ مِنْ بَعْدِ  
قُوَّةٍ ضَعْفًا وَشَيْبَةً ۗ يَخْلُقُ مَا يَشَاءُ ۗ وَهُوَ  
الْعَلِيمُ الْقَدِيرُ ﴿٥٥﴾

وَيَوْمَ تَقُومُ السَّاعَةُ يُقْسِمُ الْمُجْرِمُونَ  
مَا لَبِثُوا غَيْرَ سَاعَةٍ ۗ كَذَٰلِكَ كَانُوا

قوله الضميمة يعنى الضميمة  
في اللغة كقولهم الضميمة  
بضم الضميمة

16. Ajetet 49 – 51 flasin për ciklin e ujit se si avujt ngrihen nga detet, përplasen me male dhe më pas shkarkohen si ujë i pastër nëpër tokë, duke shkaktuar jetë e gjallëri. Po të mos ishte ky sistem prej Allahut të Madhërishëm, do të ishte e pamundur të zhvillohej jeta në Tokë. E njëjta formulë vepron edhe në botën shpirtërore, me ringjalljen e një populli shpirtërisht dhe moralisht të vdekur, përmes ardhjes së një profeti të Zotit. Siç shiu bie prej qiellit, edhe atij uji shpirtëror, pra shpallja Hyjnore, i vjen nga Lart.

17. Pavarësisht nga ligjet që u përmendën më sipër, ky ajet thotë se vetë njeriu është përgjegjës për fatin e tij. Asnjë profet apo shpallje Hyjnore nuk mund ta çojë atë te Zoti, nëse ai vetë nuk ka vullnet për ta dëgjuar të vërtetën. Iniciativa fillimisht duhet të vijë nga vetë njeriu, rezultati më pas vjen nga Zoti. Zoti nuk ka lënë imponim në çështjen e besimit.

Kështu mashtroheshin ata (edhe më parë).

57. Dhe ata të cilëve u janë dhënë dija e besimi, do të thonë: “Në Librin e Allahut ju keni qëndruar deri në Ditën e Ringjalljes dhe ja ku (erdhi) Dita e Ringjalljes, por ju nuk e dinit.”

58. Pra, atë ditë atyre që bënë të këqija, nuk do t’u bëjë dot dobi justifikimi i tyre dhe ata as nuk do të mund të kërkojnë falje.

59. Sigurisht, Ne kemi dhënë çdolloj shembulli për njerëzit në këtë Kuran. Dhe kur ti u sjell ndonjë shenjë, ata që mohuan patjetër do të thonë: “Ju vetëm gënjeni.”

60. Kështu Allahu vulos zemrat e atyre që nuk dinë.<sup>18</sup>

61. Andaj, duro. Sigurisht, premtimi i Allahut është i vërtetë dhe ty nuk duhet të të lëkundin ata që nuk besojnë.

يُؤْفَكُونَ ﴿٢٧﴾

وَقَالَ الَّذِينَ أُوتُوا الْعِلْمَ وَالْإِيمَانَ لَقَدْ لَبِئْتُمْ فِي كِتَابِ اللَّهِ إِلَى يَوْمِ الْبَعْثِ فَهَذَا يَوْمَ الْبَعْثِ وَلَكِنَّكُمْ كُنتُمْ لَا تَعْلَمُونَ ﴿٢٧﴾

فَيَوْمَئِذٍ لَا يَنْفَعُ الَّذِينَ ظَلَمُوا مَعذِرَتُهُمْ وَلَا هُمْ يُسْتَعْتَبُونَ ﴿٢٨﴾

وَلَقَدْ صَرَبْنَا لِلنَّاسِ فِي هَذَا الْقُرْآنِ مِنْ كُلِّ مَثَلٍ وَلَنْ جِئْتَهُمْ بِآيَةٍ يَقُولَنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا إِنْ أَنْتُمْ إِلَّا مُبْطِلُونَ ﴿٢٩﴾

كَذَلِكَ يَطْبَعُ اللَّهُ عَلَى قُلُوبِ الَّذِينَ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٣٠﴾

فَاصْبِرْ إِنَّ وَعْدَ اللَّهِ حَقٌّ وَلَا يَسْحَفَنَّكَ الَّذِينَ لَا يُوقِنُونَ ﴿٣١﴾

18. Lexoni 2:8 dhe 61:6.

## Surja 31 – Lukman

Surja Lukman është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka tridhjetë e pesë ajete.

Edhe kjo sure fillon me shkurtesat *Elif.Lam.Mim*. dhe këtu janë përsëritur në një aspekt të ri temat e sures El-Bekare, surja e parë që fillon me të njëjtat shkurtesa. Po kështu, surja El-Bekare në fillim përmend “Librin” dhe zbritjen e tij, edhe kjo sure e përmend zbritjen e udhëzimit prej Allahut të Madhërishëm. Megjithatë, këtu kjo temë ka sjellë një stad shumë më të lartë zhvillimi shpirtëror, pasi atje Libri do të bëhej udhëzim për ata që do të posedonin kuptimin bazë të *takvasë* (druajtjes), pra ata që kanë guximin të thonë dhe të pranojnë të vërtetën ashtu siç është, kurse këtu Libri është mjet udhëzimi për njerëzit që janë lartësuar edhe më tej dhe që nga njerëzit me *takva*, janë bërë mirëbërës (*muhsin*). Udhëzimi ka shumë grada të tjera të mëtejshme, madje të pafundme, të cilat burojnë nga ky Libër i mahnitshëm e urtiplotë.

Kjo sure edhe njëherë thekson se Allahu i Madhërishëm ka fuqi të panumërta, të cilat ne nuk mund t'i shohim dot me sytë tanë fizikë, siç është fuqia e gravitetit, atëherë si mund të shohim me këta sy Vetë Krijuesin e fuqive të tilla!

Hazret Lukmani<sup>as</sup> ishte i famshëm për urtësinë e tij. Pas shkurtesave të para “*Elif.Lam.Mim*.”, duke përmendur Librin, kjo sure i shton edhe cilësinë e të Urtit “*El-Hakim*”, gjë që tregon se do të shpalojen në vijim fjalë urtiplota të Lukmanit.

Fjala më e rëndësishme e Lukmanit është ajo që i jep si këshillë djalit të vet duke thënë: Kurrë mos bëj *shirk*, pra mos i atribuohet Allahut ortak a zota të tjerë, qoftë në adhurimin, qoftë në dashurinë ndaj Tij. Më pas, e këshilloi t'u bënte mirësi prindërve, sepse edhe ata janë një pasqyrë e vogël e atributit Krijues të Zotit (*Rrab*), sepse bëhen shkak i lindjes së fëmijës dhe i rritjes së tij.

Më pas, Lukmani porositi të birin: Nëse ke qoftë një grimë *shirku* në zemër, i Gjithëdijshmi dhe i Urti Allah do ta dijë atë, sepse Ai është në dijeni edhe për farat e vogla që gjenden të fshehura mes shkëmbinjve në Tokë dhe Ai është i Gjithinformuari (*Khabir*). Cilësia *Khabir* (i Gjithinformuar) na tregon se Ai është në dijeni edhe për zhvillimet që do të bëhen në të ardhmen, qoftë me farat e fshehura në tokë, qoftë me mendimet e fshehura nëpër kraharorët e njerëzve.

Më pas vjen porosia qendrore, e cila në suren El-Bekare është e para, pra, ajo e ngritjes ose e lartësimit të namazit. Realisht, jeta e besimtarit varet nga lartësimi i namazit të tij dhe se edhe mundësia për të porositur veprat e mira dhe për të ndaluar nga të këqijat, atij i jepet pikërisht për shkak të lartësimit të namazit. Por zakonisht njeriu të cilit Allahu i jep çdo mundësi për të bërë mirësi, tregohet mosmirënjohës dhe mburret përpara të tjerëve duke kërveshur fytyrën edhe për gjëra të vogla që gëzon. Andaj, kjo sure i jep porosinë e përlësisë duke thënë: Ec me përlësi në tokë dhe ule zërin kur flet.

Pas kësaj, kjo sure të porositi të jesh mirënjohës, e cila është një ndër temat kryesore të saj. Hazret Lukmani<sup>as</sup> vazhdimisht e porositi të birin për të qenë falënderues. Edhe urtësia e Hazret Lukmanit<sup>as</sup> si epiqendër e ka pikërisht falënderimin e Zotit, me të

cilin fillojnë porositë e tij. Në fakt, bekimet e Zotit nuk kanë fund, pasi Ai nënshtroi qiellin, tokën dhe të gjitha forcat e tyre për njeriun dhe për zhvillimin e tij, madje edhe galaktikat që ndodhen larg në ndonjë cep tjetër të universit, lëshojnë ndikimet e tyre për zhvillimin e njeriut. Megjithatë, ka njerëz që nuk dinë asgjë për universin, por që thurin gjithfarë fjalësh të padenja rreth Zotit të Madhërishëm. Ata nuk kanë as ndonjë udhëzim dhe as ndonjë libër të ndritur qiellor, i cili t'u ketë dhënë mësimin e *shirkut*.

Fjalët që përmendi kjo sure në këtë kontekst janë "*kitabum-munir*" (Libër i ndritur), gjë që tregon se idhujtarët edhe mund të bazohen te ndonjë libër për idhujtarinë e tyre, siç disa bazohen te vedat, për shembull, por vedat nuk kanë asnjë argument me dritë, përkundrazi, i shtynë ithtarët e tyre drejt errësirës edhe më shumë.

Sekretet e urtësisë dhe të fuqive të Zotit që janë të përhapura në univers, askush nuk mund t'i rrethojë dot, edhe sikur të gjitha detet të bëheshin bojë shkrimi dhe të gjitha pemët pena, detet do të thaheshin dhe pemët do të mbaronin, por përshkrimi i sekreteve të fuqisë së Allahut nuk do të përfundonte.

Pas kësaj vjen një ajet (ajeti nr. 29), i cili shpalos në mënyrë të çuditshme misteret e krijimit të njeriut. Kjo sure i tërheq vëmendjen njeriut se nëse studion fetusin që zhvillohet në mitër, do të shohë se ai kalon një sërë etapash të krijimit dhe aty ai mund të mësojë diçka edhe rreth misterit të krijimit të tij të parë. Sot shkencëtarët pohojnë me bindje se ndryshimet që pëson fëmija që nga ngjizja deri te lindja, janë një pasqyrë e ndryshimeve që njeriu ka kaluar gjatë procesit të evolucionit. Si të thuash, përsëritet i njëjti skenar i evolucionit në mitrën e nënës. Kjo temë është shumë e gjerë dhe e thellë, të cilën shkencëtarët e sotëm e paraqesin me argumente. Me fjalë të tjera, duke iu drejtuar njerëzve, Zoti thotë: Kjo është lindja juaj e parë; ashtu siç ju jeni nisur me një mikroorganizëm dhe, duke u zhvilluar, fituat deri në përsosmëri të gjitha aftësitë njerëzore, në të njëjtën mënyrë, do të jetë edhe lindja juaj e dytë për Ditën e Gjykimit, dhe deri atëherë, shqisat dhe aftësitë tuaja do të zhvillohen kaq shumë, saqë do të duket se krahasimi do të jetë i njëjtë siç ishte gjatë krijimit të parë, ai i një mikroorganizmi me fëmijën që lind me të gjitha aftësitë e tij.

Kjo sure mbyllet me deklaratën se vetëm Allahu e di se kur do të vijë Ora ose Çasti që përmendet këtu, në të cilën njeriu do të ringjallet në gjendje të përsosur. Në këtë kontekst, janë përmendur edhe disa elemente të tjera, të cilat i di vetëm Zoti, dhe njeriu nuk mund të barazohet dot me Zotin në këtë dije të Tij. Pra, kur do të bjerë shi, çfarë kanë nënat në mitrat e tyre, çfarë do të fitojë njeriu të nesërmen dhe se në cilin vend atij do t'i vijë vdekja.

Këtu duhet t'i përgjigjemi një pyetjeje. Në këtë kohë të shkencës e të teknologjisë, pretendohet se me aparatura të ndryshme dallohet se çfarë ka në mitër, djalë a vajzë, dhe se fëmija është i shëndetshëm apo jo etj.. Por, pavarësisht nga kjo, nuk mund të parashikohet njëqind për qind se nëse fëmija është me të meta apo i shëndetshëm. Mjekët pohojnë vetëm atë që sipas tyre është e mundshme. Disa herë gjinekologët pohojnë me bindje për ndonjë të metë të fëmijës, por fëmija lind i shëndetshëm.





1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. *Elif.Lam.Mim.* (Unë jam Allahu, më i Dijshmi.)

الْمَع ②

3. Këto janë ajetet e Librit urtiplotë.

تِلْكَ آيَاتُ الْكِتَابِ الْحَكِيمِ ③

4. Janë udhëzim dhe mëshirë për mirëbërësit.

هُدًى وَرَحْمَةً لِّلْمُحْسِنِينَ ④

5. (Për) ata që falin namazin, japin zekatin dhe që *ahiretin* e besojnë me bindje.

الَّذِينَ يُقِيمُونَ الصَّلَاةَ وَيُؤْتُونَ الزَّكَاةَ  
وَهُمْ بِالْآخِرَةِ هُمْ يُوقِنُونَ ⑤

6. Pikërisht këta janë në udhëzim prej Zotit të tyre dhe pikërisht këta janë të suksesshmit.

أُولَئِكَ عَلَىٰ هُدًى مِّن رَّبِّهِمْ وَأُولَئِكَ هُمُ  
الْمُفْلِحُونَ ⑥

7. Ka nga ata që zgjedhin biseda të kota në këmbim (të së mirës), që t'i devijojnë (të tjerët) nga rruga e Allahut pa pasur dije, dhe e marrin për tallje (rrugën e Allahut). Të tillët kanë ndëshkim poshtërues.

وَمِنَ النَّاسِ مَن يَشْتَرِي لَهْوَ الْحَدِيثِ  
لِيُصَلَّ عَنْ سَبِيلِ اللَّهِ بِغَيْرِ عِلْمٍ  
وَيَتَّخِذَهَا هُزُوًا ۗ أُولَئِكَ لَهُمْ عَذَابٌ  
مُّهِينٌ ⑦

8. Kur atyre u lexohen ajetet Tona, ata e kthejnë shpinën duke u mburrur, sikur nuk i kanë dëgjuar ato, sikur kanë dyllë në veshët e tyre. Jepu lajmin “e mirë” të një ndëshkimi të dhimbshëm.

وَإِذَا تُلِيَتْ عَلَيْهِ آيَاتُنَا وَكُنَّا  
كَانَ لَمْ يَسْمَعْهَا كَأَنَّ فِي أُذُنَيْهِ وَقْرًا ۗ  
فَبَشِّرْهُ بِعَذَابٍ أَلِيمٍ ⑧

9. Sigurisht, ata që besuan dhe bënë të mira, kanë kopshte me plot bekime.

إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَهُمْ  
جَنَّاتُ النَّعِيمِ ⑨

10. Ata do të jetojnë në to përgjithmonë. Premtimi i Allahut është i vërtetë dhe Ai është i Plotfuqishmi, i Urti.

خُلِدِينَ فِيهَا وَعَدَّ اللَّهُ حَقًّا وَهُوَ الْعَزِيزُ  
الْحَكِيمُ ﴿١٠﴾

11. Ai krijoi qiejt pa ndonjë shtyllë që mund ta shikonit dhe vuri male në tokë që (ato) t'ju sigurojnë ushqim dhe në të krijoi çdolloj gjallese. Dhe Ne zbritëm ujë prej qiellit dhe nxorëm në këtë (tokë) çdolloj çifti fisnik.

خَلَقَ السَّمَوَاتِ بِغَيْرِ عَمَدٍ تَرَوْنَهَا وَالْأَرْضِ فِي  
الْأَرْضِ رَوَاسِيَ أَنْ تَمِيدَ بِكُمْ وَبِتُّ فِيهَا  
مِنْ كُلِّ دَابَّةٍ وَأَنْزَلْنَا مِنَ السَّمَاءِ مَاءً  
فَأَنْبَتْنَا فِيهَا مِنْ كُلِّ زَوْجٍ كَرِيمٍ ﴿١١﴾

12. Ky është krijimi i Allahut. Tani, më tregoni atë që krijuan të tjerët përveç Tij! Por të padrejtët janë në devijim të qartë.

هَذَا خَلْقُ اللَّهِ فَأَرُونِي مَاذَا خَلَقَ الَّذِينَ  
بِغَيْرِهِ مِنْ دُونِهِ بَلِ الظَّالِمُونَ فِي ضَلَالٍ مُّبِينٍ ﴿١٢﴾

13. Ne i dhamë Lukmanit urtësinë (duke thënë): Falëndero Allahun, dhe kushdo që falënderon, falënderon për veten e tij dhe kushdo që bëhet mosmirënjohës, (ta dijë se) Allahu pa dyshim është i Pavarur, i Lavdishëm.<sup>1</sup>

وَلَقَدْ آتَيْنَا لُقْمَانَ الْحِكْمَةَ أَنْ اشْكُرْ لِلَّهِ  
وَمَنْ يَشْكُرْ فَإِنَّمَا يَشْكُرُ لِنَفْسِهِ وَمَنْ  
كَفَرَ فَإِنَّ اللَّهَ غَنِيٌّ حَمِيدٌ ﴿١٣﴾

14. Dhe kur Lukmani i tha të birit të vet, tek po e këshillonte: O biri im! Mos i atribuohet ortakë Allahut! T'i atribuosh ortak Atij, pa dyshim, është një e keqe shumë e madhe.<sup>2</sup>

وَإِذْ قَالَ لُقْمَانُ لِابْنِهِ وَهُوَ يَعِظُهُ يَا بُنَيَّ  
لَا تُشْرِكْ بِاللَّهِ إِنَّ الشِّرْكَ لَظُلْمٌ عَظِيمٌ ﴿١٤﴾

1. Zoti thotë: “Ne i dhamë Lukmanit urtësinë”, dhe më pas thotë që gjëja e parë për ta arritur urtësinë është: Bëhu rob mirënjohës i Zotit.

2. Mos sajoni diçka tjetër përballë Zotit. Të sajosh a të besosh diçka tjetër përballë Zotit quhet *shirk*. Dhe shirku është padrejtësi shumë e madhe. *Shirku* ose idhujtaria ka tri lloje. E para është idhujtaria e zakonshme, kur njerëzit adhurojnë idhuj, gur, pemë etj.. Por ky është lloji më i trashë i idhujtarisë. Lloji i dytë është të besosh tej mase te mjetet, duke menduar, për shembull – po të mos ishte ajo gjë e caktuar, do të shkatërrohesha. Edhe ky është *shirk*. Lloji i tretë i *shirkut* është të vlerësosh veten si diçka përballë fuqive të Zotit të Madhërisëm. Në *shirkun* e trashë në këtë kohë shkence dhe teknologjie, pakkush përfshihet, por pikërisht në këtë kohë të zhvillimit material, njerëzit janë të zhytur në *shirkun* e mjeteve, pra, që besojnë tej mase vetëm te mjetet.

15. Ne e porositëm njeriun rreth prindërve të tij; nëna e mbarti atë në dobësi pas dobësie pastaj gjidhënia e tij (u plotësua) për dy vjet; Më falëndero Mua dhe prindërit e tu. Tek Unë është kthimi.

16. Nëse ata grinden me ty që të bësh ortak me Mua dikë a diçka për të cilën nuk ke dije, mos iu bind atyre dhe bashkëjeto me ta në këtë botë ashtu siç duhet dhe ndiq rrugën e atij që është anuar ndaj Meje. Më pas tek Unë do të jetë kthimi juaj, atëherë do t'ju tregoj për atë që bënit.

17. O biri im! Edhe sikur të ketë diçka që peshon sa një kokërr sinapi dhe ajo të gjendet nën ndonjë shkëmb, ose në qiej, ose në tokë, Allahu do ta nxjerrë atë. Sigurisht, Allahu është i Mprehtë, i Gjithinformuar.

18. O biri im! Fal namazin, porosit për të mirën, ndalo nga e keqja dhe duro mbi atë (vështirësi) që të gjen. Sigurisht, kjo është një punë shumë e rëndësishme.

19. Mos e kërvesh fytyrën (nga inati) para njerëzve, dhe mos ec nëpër tokë duke u mburrur. Njëmend, Allahu nuk do asnjë mendjemadh (dhe) mburravec.

20. Ec i përmbajtur dhe ule zërin tënd. Pa dyshim, zëri më i papëlqyer është zëri i gomarit.

وَوَصَّيْنَا الْإِنْسَانَ بِوَالِدَيْهِ حَمَلَتْهُ أُمُّهُ  
وَهُنَّا عَلَىٰ وَهْنٍ وَفِصْلُهُ فِي عَامَيْنِ أَنِ  
اشْكُرْ لِي وَلِوَالِدَيْكَ ۖ إِلَى الْمَصِيرِ ﴿١٥﴾

وَإِنْ جَاهَدَكَ عَلَىٰ أَنْ تُشْرِكَ بِي مَا لَيْسَ  
لَكَ بِهِ عِلْمٌ فَلَا تُطِعْهُمَا وَصَاحِبُهَا  
فِي الدُّنْيَا مَعْرُوفًا ۖ وَأَتَّبِعْ سَبِيلَ مَنْ  
أَنَابَ إِلَيَّ ۚ ثُمَّ إِلَىٰ مَرْجِعِكُمْ فَأُنَبِّئُكُمْ بِمَا  
كُنتُمْ تَعْمَلُونَ ﴿١٦﴾

يَبْنَئِي إِيَّاهَا إِنْ تَكُ مِثْقَالَ حَبَّةٍ مِّنْ  
خَرْدَلٍ فَتَكُنْ فِي صَخْرَةٍ أَوْ فِي السَّمَوَاتِ  
أَوْ فِي الْأَرْضِ يَأْتِ بِهَا اللَّهُ ۗ إِنَّ اللَّهَ  
لَطِيفٌ خَبِيرٌ ﴿١٧﴾

يَبْنَئِي أِقِمِ الصَّلَاةَ وَأْمُرْ بِالْمَعْرُوفِ وَانْهَ  
عَنِ الْمُنْكَرِ وَأَصِرْ عَلَىٰ مَا آصَابَكَ ۗ إِنَّ  
ذَلِكَ مِنْ عَزْمِ الْأُمُورِ ﴿١٨﴾

وَلَا تُصَعِّرْ خَدَّكَ لِلنَّاسِ وَلَا تَمْشِ فِي  
الْأَرْضِ مَرَحًا ۗ إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ كُلَّ مُخْتَالٍ  
فَخُورٍ ﴿١٩﴾

وَاقْصِدْ فِي مَشْيِكَ وَاعْظُضْ مِنْ  
صَوْتِكَ ۗ إِنَّ أَنْكَرَ الْأَصْوَاتِ لَصَوْتُ  
الْحَبِيرِ ﴿٢٠﴾

21. A nuk e keni parë se Allahu nënshtroi për ju gjithçka që është në qiej dhe gjithçka që është në tokë, dhe ju plotësoi bekimet e Tij, edhe së jashtmi, edhe së brendshmi?! Prej njerëzve ka të tillë që grinden rreth Allahut pa pasur as dije, as udhëzim dhe as ndonjë libër të qartë.

22. Dhe kur u thuhet: “Ndiqni atë që zbriti Allahu!”, thonë: “Jo, do ta ndjekim atë, në të cilën gjetëm baballarët tanë!” Vallë, edhe sikur djalli t’i thërriste ata drejt ndëshkimit të zjarrit?!

23. Dhe se kushdo që i dorëzohet Allahut dhe është mirëbërës, ka kapur lidhjen më të fortë. Tek Allahu është fundi i çështjeve.

24. Nëse dikush mohon, mohimi i tij nuk duhet të të brengosë ty. Te Ne është kthimi i tyre, atëherë do t’ua tregojmë atë që ata bënin. Sigurisht, Allahu është i Gjithëdijshëm për gjithçka që mbajnë kraharorët.

25. Ne i bëjmë të përfitojnë për-kohësisht, më pas i detyrojmë drejt një ndëshkimi të rëndë.

26. Nëse i pyet: “Kush i krijoi qiejt dhe tokën?”, do të thonë patjetër: “Allahu!”. Thuaj: “Lavdia është e Allahut.” Por shumica e tyre nuk dinë.

27. E Allahut është gjithçka që është nëpër qiej e tokë. Pikërisht Allahu është i Pavaruri, i Lavdishmi.

أَلَمْ تَرَوْا أَنَّ اللَّهَ سَخَّرَ لَكُمْ مَّا فِي السَّمَوَاتِ  
وَمَا فِي الْأَرْضِ وَأَسْبَغَ عَلَيْكُمْ نِعْمَهُ  
ظَاهِرَةً وَبَاطِنَةً ۗ وَمِنَ النَّاسِ مَن يُجَادِلُ  
فِي اللَّهِ بِغَيْرِ عِلْمٍ وَلَا هُدًى وَلَا كِتَابٍ  
مُنِيرٍ ﴿٢١﴾

وَإِذَا قِيلَ لَهُمُ اسْبِعُوا مَا أَنْزَلَ اللَّهُ قَالُوا  
بَلْ نَنْبَغُ مَا وَجَدْنَا عَلَيْهِ آبَاءَنَا ۗ أَوْ لَوْ كَانَ  
الشَّيْطَانُ يَدْعُوهُمْ إِلَىٰ عَذَابِ السَّعِيرِ ﴿٢٢﴾

وَمَنْ يُسْلِمْ وَجْهَهُ إِلَى اللَّهِ وَهُوَ مُحْسِنٌ  
فَقَدْ اسْتَمْسَكَ بِالْعُرْوَةِ الْوُثْقَىٰ ۗ وَإِلَى اللَّهِ  
عَاقِبَةُ الْأُمُورِ ﴿٢٣﴾

وَمَنْ كَفَرَ فَلَا يَحْزَنكَ كُفْرُهُ ۗ إِيَّا  
مَرْجِعَهُمْ فَنُذِيبُهُمْ بِمَا عَمِلُوا ۗ إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ  
بِدَاتِ الصُّدُورِ ﴿٢٤﴾

نَمَتُّهُمْ قَلِيلًا ثُمَّ نَضَّضُّهُمْ إِلَىٰ عَذَابٍ  
غَلِيظٍ ﴿٢٥﴾

وَلَيْنَ سَأَلْتَهُمْ مَّنْ خَلَقَ السَّمَوَاتِ  
وَالْأَرْضَ لَيَقُولُنَّ اللَّهُ ۗ قُلِ الْحَمْدُ لِلَّهِ ۗ  
بَلْ أَكْثَرُهُمْ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٢٦﴾

لِلَّهِ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ۗ إِنَّ اللَّهَ هُوَ  
الْغَنِيُّ الْحَمِيدُ ﴿٢٧﴾

28. Të gjitha pemët që ka toka sikur të bëheshin pena, dhe deti (të bëhej bojë shkrimi) dhe pas tij të shtoheshin edhe shtatë dete të tjera, nuk do të përfundonin fjalët e Allahut. Sigurisht, Allahu është Mbizotërues, i Urtë.

29. Edhe krijimi juaj, edhe ringjallja juaj janë si (krijimi dhe ringjallja) e një shpirti të vetëm. Sigurisht, Allahu është Gjithëdhëgues, Largpamës.

30. A nuk e pe se Allahu fut natën në ditë dhe fut ditën në natë dhe vuri në shërbim diellin dhe hënën?! Secili lëviz drejt një afati të përcaktuar dhe se Allahu është i Gjithinformuar për atë që bëni.

31. Kështu është sepse pikërisht Allahu është i Vërteti dhe ajo që ata lusin në vend të Tij, është e gënjeshtërtë dhe se pikërisht Allahu është i Larti, i Madhi.

32. A nuk e pe se anijet lundrojnë në det me bekimin e Allahut, që t'ju tregojnë juve disa nga shenjat e Tij?! Sigurisht, në këtë ka shenja për çdo të duruar (dhe) mirënjohës.

33. Kur dallgët i mbulojnë porsijet, ata i luten Allahut duke ia përkushtuar besimin vetëm Atij. Dhe kur Ai i shpëton drejt bregut,

وَلَوْ أَنَّ مَا فِي الْأَرْضِ مِنْ شَجَرَةٍ أَقْلَامٌ  
وَالْبَحْرُ يَمُدُّهُ مِنْ بَعْدِهِ سَبْعَةُ أَبْحُرٍ مَا  
نَفَدْتَ كَلِمَتُ اللَّهِ إِنَّ اللَّهَ عَزِيزٌ  
حَكِيمٌ ﴿٢٨﴾

مَا خَلَقَكُمْ وَلَا بَعَثَكُمْ إِلَّا كَنَفْسٍ  
وَاحِدَةٍ إِنَّ اللَّهَ سَمِيعٌ بَصِيرٌ ﴿٢٩﴾

أَلَمْ تَرَ أَنَّ اللَّهَ يُوَلِّجُ اللَّيْلَ فِي النَّهَارِ  
وَيُوَلِّجُ النَّهَارَ فِي اللَّيْلِ وَسَخَّرَ الشَّمْسَ  
وَالْقَمَرَ كُلًّا يَجْرِي إِلَىٰ أَجَلٍ مُّسَمًّى وَأَنَّ  
اللَّهَ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرٌ ﴿٣٠﴾

ذَلِكَ بِأَنَّ اللَّهَ هُوَ الْحَقُّ وَأَنَّ مَا يَدْعُونَ  
مِنْ دُونِهِ أَبَاطِلٌ وَأَنَّ اللَّهَ هُوَ الْعَلِيُّ  
الْكَبِيرُ ﴿٣١﴾

أَلَمْ تَرَ أَنَّ الْفُلْكَ تَجْرِي فِي الْبَحْرِ بِنِعْمَتِ  
اللَّهِ لِيُرِيَكُمْ مِنْ آيَاتِهِ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ  
لِّكُلِّ صَبَّارٍ شَكُورٍ ﴿٣٢﴾

وَإِذَا غَشِيَهُمْ مَوْجٌ كَالظَّلِيلِ دَعَوْا اللَّهَ  
مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ فَلَمَّا نَجَّاهُمْ إِلَى

prej tyre ka nga ata që mbajnë qëndrim të mesëm. Askush nuk i kundërshton shenjat Tona, përveç atyre që janë tepër mashtrues (dhe) mosmirënjohës.<sup>3</sup>

34. O njerëz! Kini druajtje ndaj Zotit tuaj dhe kini frikë nga dita kur nuk do t'i bëjë dot dobi as babai të birit dhe as i biri nuk do t'i vlejë për asgjë babait. Sigurisht, premtimi i Allahut është i vërtetë, andaj, nuk duhet t'ju mashtrojë jeta e kësaj bote, dhe (djalli) mashtrues nuk duhet t'ju mashtrojë në lidhje me Allahun.

35. Pa dyshim, tek Allahu është dija për Orën. Ai zbret shiun, di atë që gjendet në mitra; asnjë shpirt nuk di se çfarë do të punojë nesër dhe asnjë shpirt nuk di se në cilën tokë do të vdesë. Njëmend, Allahu është i Gjithëdijshëm, i Gjithinformuar.<sup>4</sup>

الْبَرِّ فَمِنْهُمْ مُقْتَصِدٌ ۖ وَمَا يَجْحَدُ بِآيَاتِنَا إِلَّا كُلُّ خَتَّارٍ كَفُورٍ ﴿٣٣﴾

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ وَأَحْسُوا يَوْمًا لَا يَجْزِي وَالِدٌ عَنْ وَلَدِهِ ۚ وَلَا مَوْلُودٌ هُوَ جَازٍ عَنْ وَالِدِهِ شَيْئًا ۚ إِنَّ وَعْدَ اللَّهِ حَقٌّ فَلَا تَغُرَّنَّكُمُ الْحَيَاةُ الدُّنْيَا ۖ وَلَا يَغُرَّنَّكُم بِاللَّهِ الْعُرُورُ ﴿٣٤﴾

إِنَّ اللَّهَ عِنْدَهُ عِلْمُ السَّاعَةِ ۖ وَيُنزِّلُ الْغَيْثَ ۖ وَيَعْلَمُ مَا فِي الْأَرْحَامِ ۖ وَمَا تَدْرِي نَفْسٌ مَّاذَا تَكْسِبُ غَدًا ۖ وَمَا تَدْرِي نَفْسٌ بِأَيِّ أَرْضٍ تَمُوتُ ۚ إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ خَبِيرٌ ﴿٣٥﴾

3. Ky ajet paraqet një aspekt të rëndësishëm të psikologjisë njerëzore. Kur njerëzit ngecin në det, të rrethuar nga një stuhi e dallgëzuar, çdokush prej tyre, qoftë ai që nuk beson, qoftë ai që beson në Zot por që adhuron edhe idhuj të tjerë në besimin e tij, i lutet Vetëm Zotit, pra Allahut. Dhe kur Allahu i shpëton ata duke i nxjerrë drejt bregut, ata kthehen në gjendjen e tyre të mëparshme shpirtërore. Megjithatë, në këtë pohim Allahu bën përjashtim për “*muktesidinet*”, pra ata që nuk i tejkalojnë kufijtë dhe mbajnë qëndrim të mesëm, sepse të tillët edhe kur shpëtojnë, nuk e harrojnë që ishte Zoti Ai që i kishte shpëtuar.

4. Një lexim i vëmendshëm i këtij ajeti na tregon se nga pesë gjëra që janë përmendur në këtë ajet, për shiun dhe për fëmijën në mitër, Allahu i Madhërishëm nuk pohon “asnjë njeri nuk di”, siç e thotë në tri çështjet e tjera. Andaj, shohim që sot njeriu me anë të shkencës parashikon deri diku kushtet meteorologjike dhe po kështu edhe gjininë e fetusit. Megjithatë, askush nuk parashikon dot nëse shiu dhe fëmija do t'i sjellin mbarësi apo jo. Këtë e di vetëm Ai që është i Gjithëdijshëm dhe i Gjithinformuar.

## Surja 32 – Es-Sexhde

Surja Es-sexhde është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ajo ka tridhjetë e një ajete.

Edhe kjo sure fillon me shkurtesat *Elif.Lam.Mim*, që do të thotë *Ene Allahu A'lem*, Unë jam Allahu, i Gjithëdijshmi, shkurtesa të cilat kanë një lidhje me ajetin e fundit të sures paraardhëse, ku thuhej se ka disa gjëra që i di vetëm Allahu dhe askush tjetër.

Pas kësaj, edhe njëherë shpalosen disa nga sekretet e qiejve e të tokës, të cilat, sërish, nuk mund t'i dinte askush tjetër përveç Zotit të Gjithëdijshëm. Më pas vjen një ajet, i cili në mënyrë befasuese, duket se zbulon misterin e moshës së universit. Allahu i Madhërishëm thotë: “Një ditë tek Allahu është sa një mijë vjet që llogaritni ju”. Nëse do të shumëzohet një vit tonin me një mijë vjet, shuma që del është përmendur në këtë ajet (365,000 vjet). Veç kësaj, ka edhe një ajet tjetër (70:5), në të cilin Allahu i Madhërishëm thotë se një ditë e Allahut është e barabartë me pesëdhjetë mijë vjet. Tani, nëse 50,000 vjet shumëzohen me shumën e mëparshme, shkojnë rreth 20 miliardë vite (18,250,000,000). Sipas shkencëtarëve kjo është përafërsisht moshë e universit. Në vazhdë të kësaj teme, Allahu i Madhërishëm edhe njëherë pohoi: I Dijshmi i së dukshmes dhe i së padukshmes është vetëm Ai, i cili çdo gjë krijoi në mënyrë të shkëlqyer. Ajo që është e habitshme, siç thotë ajeti vijues, është se gjithë krijimi në Tokë u bë prej dheu. Më pas surja flet për etapa të mëtejshme të krijimit, në të cilat, fara e njeriut zhvillohet fazë pas faze në mitër.

Pas kësaj teme, kjo sure diskuton dyshimin e njerëzve që ata kanë për jetën pas vdekjes. Duke i dhënë përgjigje kësaj çështjeje, kjo sure ka zbuluar një pikë të re dhe tha se çdo njeri e ka të veçuar engjëllin e vdekjes së tij, i cili me siguri llogarit dëmtimet dhe prishjet më të vogla të trupit të njeriut për të nxjerrë përfundimin e saktë se kur duhet t'ia marrë shpirtin atij. Këtu na kujtohet ajo që është përmendur në ajetin e fundit të sures paraardhëse, ku e njëjta gjë u tha në një aspekt tjetër.

Shkurtesat e kësaj sureje siç e thamë në fillim flasin për dijen ekskluzive të Allahut dhe në këtë kontekst, shohim që në *rukunë* e fundit (ajeti nr. 24), përmendet *Hazret Musai*<sup>as</sup>, dhe më pas vijnë fjalët: Mos dysho në takimin me të. Sipas disa komentuesve, këtu nuk flitet për takimin me Allahun, por për takimin e *Hazret Profetit Muhammed*<sup>savs</sup> me *Hazret Musain*<sup>as</sup>. Nëse e marrim pikërisht këtë kuptim, sërish kjo nuk i referohet takimit të gjithë Profetëve që do të bëhet Ditën e Gjykimit, por i referohet në mënyrë të veçantë takimit vetëm të këtyre dy Profetëve madhorë, i cili u zhvillua në udhëtimin e Miraxhit, ku *Hazret Musai*<sup>as</sup>, i dha një këshillë Profetit Muhammed<sup>savs</sup> në lidhje me namazin, ngjarje të cilën mund ta lexoni [në hadithe] ku përmendet më me detaje rreth këtij udhëtimi.

Në ajetin e fundit të kësaj sureje, Allahu i Madhërishëm e porositi Profetin Muhammed<sup>savs</sup> të tregohet i duruar ndaj persekutimeve dhe shqetësimeve që i bëhen nga armiqtë.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. *Elif.Lam.Mim.* (Unë jam Allahu, më i Dijshmi.)

الْمِ ②

3. Zbritja e Librit, nuk ka asnjë dyshim në të, (që) është prej Zotit të botëve.

تَنْزِيلُ الْكِتَابِ لَا رَيْبَ فِيهِ مِنْ رَبِّ الْعَالَمِينَ ③

4. Ata a thonë se e ka trilluar ai? Përkundrazi, ajo është e vërteta prej Zotit tënd, që të alarmosh popullin, të cilëve nuk u erdhi ndonjë alarmues para teje, që ata të udhëzohen.

أَمْ يَقُولُونَ افْتَرَاهُ ④ بَلْ هُوَ الْحَقُّ مِنْ رَبِّكَ لِنُنذِرَ قَوْمًا مَّا أَتَاهُمْ مِنْ نَذِيرٍ مِنْ قَبْلِكَ لَعَلَّهُمْ يَهْتَدُونَ ⑤

5. Allahu është Ai që krijoi qiejt dhe tokën dhe gjithçka që gjendet mes atyre të djave në gjashtë ditë, më pas Ai u vendos në Arsh. Përveç Atij, ju nuk keni as ndonjë mik e as ndonjë ndërmjetësues. A nuk reflektoni?!

اللَّهُ الَّذِي خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ وَمَا بَيْنَهُمَا فِي سِتَّةِ أَيَّامٍ ثُمَّ اسْتَوَى عَلَى الْعَرْشِ ⑥ مَا لَكُمْ مِنْ دُونِهِ مِنْ وَلِيٍّ وَلَا شَفِيعٍ ⑦ أَفَلَا تَتَذَكَّرُونَ ⑧

6. (Allahu) drejton urdhrin prej qiellit drejt tokës. Më pas, (urdhri) ngrihet tek Ai në një ditë, e cila është e barabartë me një mijë vjet që llogaritni ju.<sup>1</sup>

يُدِيرُ الْأَمْرَ مِنَ السَّمَاءِ إِلَى الْأَرْضِ ثُمَّ يَعْرُجُ إِلَيْهِ فِي يَوْمٍ كَانَ مِقْدَارُهُ أَلْفَ سَنَةٍ مِمَّا تَعُدُّونَ ⑨

1. Ajeti i referohet një krize shumë serioze që ishte e destinuar të vinte mbi Islamit gjatë përhapjes së tij në botë. Por, përpara kësaj, Islami do të lulëzonte gjatë periudhës së tij më të bekuar dhe më të qëndrueshme, e cila përbëhej nga 3 shekujt e parë. Profeti Muhammed<sup>savs</sup> vetë e kishte parashikuar: “*Shekulli më i mirë është ai në të cilin jam unë, pastaj shekulli i ardhshëm, pastaj shekulli pasardhës*” (Buhari, nr. 2651). Pas këtyre 3 shekujve, sërish sipas profecisë së Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, muslimanët do të kishin “*fejxhun a vexhun*”, “*një epokë shtrembërish*” (Mishkat, botues: “El-Mektebel-islamij”, Bejrut 1979, hadithi 6278). Andaj, në aspektin shpirtëror, *umeti* i Islamit filloi të binte dhe ky proces i rënies së muslimanëve do të vazhdonte *një mijë vitet* e ardhshme, siç është e parashikuar në këtë ajet. Pra, deri në shekullin



7. Ky është i Dijshmi i së dukshmes dhe i të padukshmes, Mbizotëruesi, Mëshirëbërësi.

ذَلِكَ عَلِمَ الْغَيْبِ وَالشَّهَادَةِ الْعَزِيزِ  
الرَّحِيمِ ①

8. I cili çdo gjë që krijoi, e krijoi në mënyrën më të bukur dhe krijimin e njeriut e nisi prej balte.

الَّذِي أَحْسَنَ كُلَّ شَيْءٍ خَلَقَهُ وَبَدَأَ خَلْقَ  
الْإِنْسَانِ مِنْ طِينٍ ②

9. Më pas, krijoi pasardhësit e tij prej ekstrakti të një uji të papërfillshëm.

ثُمَّ جَعَلَ نَسْلَهُ مِنْ سُلَالَةٍ مِنْ مَاءٍ مَمْهِينٍ ③

10. Pastaj e përsosi atë dhe në të fryu shpirtin e Tij;<sup>2</sup> dhe Ai bëri për ju veshët, sytë dhe zemrën. Sa pak që falënderoni!

ثُمَّ سَوَّاهُ وَنَفَخَ فِيهِ مِنْ رُوحِهِ وَجَعَلَ  
لَكُمْ السَّمْعَ وَالْأَبْصَارَ وَالْأَفْئِدَةَ قَلِيلًا  
مَا تَشْكُرُونَ ④

11. Ata thonë: “Kur të humbasim në tokë, vallë, a do të dalim (sërish) në një krijim të ri?” E vërteta është që ata mohojnë takimin me Zotin e tyre.

وَقَالُوا إِذَا ضَلَلْنَا فِي الْأَرْضِ أَإِنَّا لَفِي  
خَلْقٍ جَدِيدٍ بَلْ هُمْ بِلِقَائِ رَبِّهِمْ  
كَفِرُونَ ⑤

XIII pas Profetit<sup>savs</sup>, muslimanët kishin pësuar rënie të thellë si në aspektin shpirtëror, ashtu edhe në aspektin politik. U ndanë dhe u përçanë deri në 73 *sekte*, siç ishte e parashikuar nga vetë Profeti i Shenjtë<sup>savs</sup> (Tirmidhi, nr. 2641). Është pikërisht kjo kohë njëmijëvjeçare, për të cilën flet ky ajet, që gjatë kësaj periudhe, drita Hyjnore do të ngjitej përsëri në qiell, duke e lënë *umetin* me mendje të errëta. Në një hadith tjetër, Profeti i Shenjtë ka thënë se *besimi edhe sikur të ngjitej deri në Plejadat, një njeri me prejardhje perse, do ta risillte atë në tokë* (Lexoni 62:1-6). Pra, e gjithë kjo provon se pikërisht pas 13 shekujve, në shekullin XIV pas Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, do të vinte Imam Mehdiu dhe Mesihu i Premtuar në shërbim të Kuranit dhe të të Dërguarit të Allahut<sup>savs</sup> dhe për ringjalljen e Islamit, porsi hëna e plotë e natës së 14-të për ta reflektuar dritën e diellit në kohë errësire. Kështu ngjau edhe me *umetin* e *Hazret Musait<sup>as</sup>*, që, në shekullin XIV pas tij, erdhi Mesihu Isai biri i Merjemes<sup>as</sup> për hebrejntë. E gjithë kjo përkon edhe me profecinë e Kuranit (73:16) dhe të Profetit Muhammed<sup>savs</sup> se *umeti* i Muhammedit<sup>savs</sup> është i ngjashëm me *umetin* e Musait<sup>as</sup> (Buhari, nr. 7267). Sërish, Dexhalli (18:103-111) dhe Jexhuxhët e Mexhuxhët (21:97) gjithashtu në këtë kohë janë shfaqur, por jo sipas përfytyrimeve të disa muslimanëve të sotëm, por ashtu siç deshë Zoti. Pikërisht në këtë kohë, teknologjia dhe mjetet e telekomunikacionit kanë avancuar kaq shumë sa që është tamam ajo kohë, për të cilën Kurani parashikoi se *“Islami do të triumfojë mbi të gjitha fetë e tjera”* (61:10) profeci për të cilën dijetarët ishin në ujdj që do të ndodhte në kohën e Imam Mehdiut<sup>as</sup>. Koha tregoi se kjo do të ndodhte në këtë epokë të avancimit të teknologjisë, që zëri i Imam Mehdiut dhe Mesihut të Premtuar<sup>as</sup> të përhapej me shpejtësi në të gjitha anët e botës, diçka që ishte krejt e pamundur në të kaluarën. Lexoni edhe suren 81 Et-Tekvir.

2. Lexoni 15:30.

12. Thuaj: Do t'jua marrë shpirtrat engjëlli i vdekjes që është përcaktuar mbi ju, më pas, te Zoti juaj do të ktheheni.

13. Sikur të shihje kur fajtorët do të jenë kokulur para Zotit të tyre (dhe do t'i thonë): “O Zoti ynë! Ne e pamë dhe e dëgjuam; na kthe (edhe njëherë), do të bëjmë të mira dhe ne pa dyshim jemi të bindur.”

14. Po të donim, Ne patjetër do t'i dhuronim çdo shpirti udhëzimin e tij, por është dekretuar urdhri prej Meje: Unë do të mbush xhehenemin me gjithë xhindët dhe njerëzit.<sup>3</sup>

15. Andaj, shijoni (ndëshkimin) për shkak se harruat takimin tuaj të kësaj dite. (Edhe) Ne ju kemi harruar. Dhe shijoni ndëshkimin e përjetshëm për shkak të asaj që bënit.

16. Ajetet Tona i besojnë vetëm ata të cilëve kur u jepet mësim me anë të këtyre (ajeteve), bien në sexhde, lartësojnë Zotin e tyre duke e lavdëruar Atë dhe nuk bëhen mendjemëdhenj.

17. Ata i lënë shtretërit e tyre, lusin Zotin e tyre me frikë e shpresë dhe shpenzojnë nga ajo që Ne u kemi dhënë.

قُلْ يَتَوَفَّكُم مَّلَكُ الْمَوْتِ الَّذِي وُكِّلَ بِكُمْ ثُمَّ إِلَىٰ رَبِّكُمْ تُرْجَعُونَ ﴿١٢﴾

وَلَوْ تَرَىٰ إِذِ الْمُجْرِمُونَ نَاكِسُوا رُءُوسِهِمْ عِنْدَ رَبِّهِمْ رَبَّنَا أَبْصَرْنَا وَسَمِعْنَا فَارْجِعْنَا نَعْمَلْ صَالِحًا إِنَّا مُوقِنُونَ ﴿١٣﴾

وَلَوْ شِئْنَا لَآتَيْنَا كُلَّ نَفْسٍ هُدًىٰ وَلَكِنْ حَقَّ الْقَوْلُ مِنِّي لَأَمْلَأَنَّ جَهَنَّمَ مِنَ الْجِنَّةِ وَالنَّاسِ أَجْمَعِينَ ﴿١٤﴾

فَذُوقُوا بِمَا نَسِيتُمْ لِقَاءَ يَوْمِكُمْ هَٰذَا إِنَّا نَسِينَاكُمْ وَذُوقُوا عَذَابَ الْخُلْدِ بِمَا كُنتُمْ تَعْمَلُونَ ﴿١٥﴾

إِنَّمَا يُؤْمِنُ بِآيَاتِنَا الَّذِينَ إِذَا ذُكِّرُوا بِهَا خَرُّوا سُجَّدًا وَسَبَّحُوا بِحَمْدِ رَبِّهِمْ وَهُمْ لَا يَسْتَكْبِرُونَ ﴿١٦﴾

تَتَجَافَىٰ جُوبُهُمْ عَنِ الْمَضَاجِعِ يَدْعُونَ رَبَّهُمْ خَوْفًا وَ طَمَعًا ۚ وَ مِن رَّزْقِهِمْ يُنْفِقُونَ ﴿١٧﴾

Sexhdeja X

الجنّة

3. 15:43-44 dhe 7:180 sqarojnë se me kë Zoti do ta mbushë xhehenemin.

18. Asnjë shpirt nuk di se çfarë është mbajtur e fshehtë për t'ia qetësuar syrin; si shpërblim i asaj që ata bënin.<sup>4</sup>

19. Besimtari a mund të jetë njësoj si i padëgjueshmi?! Nuk janë të barabartë.

20. Për sa u përket atyre që besuan dhe bënë të mira, do të kenë si strehë kopshte, si mikpritje për atë që ata bënin.

21. Kurse ata që u treguan të padëgjueshëm, streha e tyre do të jetë zjarri. Sa herë që ata dëshirojnë të dalin prej tij, do të detyrohen të rikthehen në të dhe do t'u thuhet: “Shijoni ndëshkimin e zjarrit, të cilin ju e quanit një gënjeshtër!”

22. Ne patjetër do t'i bëjmë ata të shijojnë ndëshkimin e vogël (të kësaj bote) përpara ndëshkimit të madh, që ata të mund të kthehen (drejt udhëzimit).

فَلَا تَعْلَمُ نَفْسٌ مَّا أُخْفِيَ لَهُم مِّن قُرَّةِ  
أَعْيُنٍ ۚ جَزَاءً لِّمَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿١٨﴾

أَفَمَن كَانَ مُؤْمِنًا كَمَن كَانَ فَاسِقًا ۚ لَّا  
يَسْتَوُونَ ﴿١٩﴾

أَمَّا الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ فَلَهُمْ  
جَنَّاتُ الْمَأْوَىٰ نُزُلًا لِّمَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿٢٠﴾

وَأَمَّا الَّذِينَ فَسَقُوا فَمَأْوَاهُمُ النَّارُ ۗ كُلَّمَا  
أَرَادُوا أَن يَخْرُجُوا مِنْهَا أُعِيدُوا فِيهَا  
وَقِيلَ لَهُمْ ذُوقُوا عَذَابَ النَّارِ الَّتِي كُنتُمْ  
بِهَا تَكذَّبُونَ ﴿٢١﴾

وَلَنُنذِرَنَّهُمْ مِنَ الْعَذَابِ الْأَلَدِيِّ دُونَ  
الْعَذَابِ الْأَكْبَرِ لَعَلَّهُمْ يَرْجِعُونَ ﴿٢٢﴾

4. Zoti i cilësoi të fshehta të gjitha bekimet e xhenetit, saqë nuk mund t'ua gjeshe shembullin në bekimet e kësaj bote. Dihet që bekimet e kësaj bote nuk janë të fshehta për ne. Ne njohim qumështin, shegën, rrushin etj., dhe ato i konsumojmë përditë. Kjo tregon se bekimet e botës tjetër janë të tjera, të cilat me bekimet e kësaj bote ngajnë vetëm në emërtime. Andaj, ai që mendon se parajsja është një koleksion bekimesh të kësaj bote, nuk ka kuptuar asnjë shkronjë të Kuranit të Shenjtë. Kjo përputhet edhe me fjalën e Udhëheqësit dhe Profetit tonë, i Dërguari i Allahut<sup>saws</sup>, ku ai thotë se xheneti dhe bekimet e tij janë gjëra që as nuk i ka parë ndonjë sy, as nuk i ka dëgjuar ndonjë vesh dhe as nuk i ka ndier ndonjë zemër (Buhari, nr. 3244). Kurse ne i shohim me sytë tanë bekimet e kësaj bote, i dëgjojmë me veshët tanë dhe i ndiejmë në zemër. Kështu që, pavarësisht se këto ushqime janë përmendur me terma fizikë, njëkohësisht është sqaruar se burimi i tyre është shpirti dhe drejtësia. Ata që kanë ngrënë ushqimin e dashurisë së Zotit në këtë botë, të njëjtin ushqim do ta gjejnë në një formë fizike edhe në botën tjetër. Dhe ngaqë ata do ta kenë shijuar këtë dashuri dhe mirësjellje Hyjnore, do ta njohin edhe atje (2:26). Për këtë arsye, shpirtrat e tyre do ta kujtojnë kohën kur ata kalonin në vetmi, nëpër qoshe dhe në errësira të natës kur përkujtonin me mall të Dashurin e Vërtetë dhe gjenin kënaqësi nga ky përkujtim. Lexoni edhe 2:26; 47:16.

23. Kush mund të jetë më i padrejtë se ai, të cilit i jepet këshillë me anë të ajeteve të Zotit të tij dhe ai prapëseprapë largohet prej tyre?! Sigurisht, Ne do të hakmerremi me fajtorët.

24. Pa dyshim, Ne i dhamë Musait Librin. Andaj, mos ki dyshim në takimin me të.<sup>5</sup> Dhe ne e bëmë atë udhëzues për Bijtë e Izraelit.

25. E kur ata duruan, Ne bëmë (disa) prej tyre udhëheqës, të cilët udhëzonin me urdhrin Tonë. Ata besonin me bindje ajetet Tona.

26. Pa dyshim, Zoti yt do të vendosë mes tyre Ditën e Kiametit për gjërat të cilat ata kundërshtonin.

27. A nuk i udhëzoi ata (fakti që) sa shumë popuj kemi shkatërruar para tyre, (edhe pse) ata ecin në vendbanimet e tyre (të braktisura)?! Sigurisht, në këtë ka shenja. A nuk dëgjojnë?!

28. A nuk kanë parë se Ne e shpiem ujin drejt tokës së shkretë dhe përmes tij nxjerrim bimësi, me të cilën ushqehen edhe bagëtitë e tyre, edhe vetë ata?! A nuk shohin?!

وَمَنْ أَظْلَمُ مِمَّنْ ذُكِّرَ بِآيَاتِ رَبِّهِ ثُمَّ  
أَعْرَضَ عَنْهَا ۗ إِنَّا مِنَ الْمُجْرِمِينَ  
مُنْتَقِمُونَ ﴿٣١﴾

وَلَقَدْ آتَيْنَا مُوسَى الْكِتَابَ فَلَا تَكُنْ فِي  
مِرْيَةٍ مِّنْ لِّقَائِهِ وَجَعَلْنَاهُ هُدًى لِّبَنِي  
إِسْرَائِيلَ ﴿٣٢﴾

وَجَعَلْنَا مِنْهُمْ أُمَّةً يَهْتَدُونَ بِأَمْرِنَا  
لَمَّا صَبَرُوا ۗ وَكَانُوا بِآيَاتِنَا يُوقِنُونَ ﴿٣٣﴾

إِنَّ رَبَّكَ هُوَ يَفْصِلُ بَيْنَهُم يَوْمَ الْقِيَامَةِ فِيمَا  
كَانُوا فِيهِ يَخْتَلِفُونَ ﴿٣٤﴾

أَوَلَمْ يَهْدِ لَهُمْ كَمَا أَهْلَكْنَا مِنْ قَبْلِهِمْ مِّنْ  
الْقُرُونِ يَمْشُونَ فِي مَسْجِدِهِمْ ۗ إِنَّ فِي ذَلِكَ  
لَآيَاتٍ لِّأَفَلَا يَسْمَعُونَ ﴿٣٥﴾

أَوَلَمْ يَرَوْا أَنَّا نَسُوقُ الْمَاءَ إِلَى الْأَرْضِ  
الْجُرْزِ فَنُخْرِجُ بِهِ زَرْعًا تَأْكُلُ مِنْهُ  
أَنْعَامُهُمْ وَانفُسُهُمْ ۗ أَفَلَا يُبْصِرُونَ ﴿٣٦﴾

5. Një kuptim i këtij ajeti është që takimi i Profetit Muhammed<sup>savs</sup> do të jetë me Hazret Musain<sup>as</sup>, dhe për këtë i thuhet: *Mos ki dyshim në këtë takim*. Në këtë rast, ndoshta ajeti i referohet takimit të këtyre dy Profetëve madhorë që u bë gjatë udhëtimit të Miraxhit, kur Profeti Muhammed<sup>savs</sup> e takoi disa herë Hazret Musain<sup>as</sup>. Kuptimi tjetër, por më i rëndësishmi, është takimi i Profetit Muhammed<sup>savs</sup> me Zotin e Madhërishëm. Ky takim përmendet në këtë kontekst, sepse ashtu siç Hazret Musai<sup>as</sup> takoi Allahun e Madhërishëm në malin Tur, edhe Profeti Muhammed<sup>savs</sup> do të gëzonte takimin me Allahun e Madhërishëm në një formë edhe më të afërt.

29. Dhe thonë: “Kur do të vijë kjo fitore, nëse jeni të vërtetë?”

وَيَقُولُونَ مَتَى هَذَا الْفَتْحِ إِنْ كُنْتُمْ  
صَادِقِينَ ﴿٢٩﴾

30. Thuaj: Ditën e fitores, besimi i atyre që mohuan nuk do t'u sjellë dobi, dhe as nuk do t'u jepet afat.

قُلْ يَوْمَ الْفَتْحِ لَا يَنْفَعُ الَّذِينَ كَفَرُوا  
إِيمَانُهُمْ وَلَا هُمْ يُنظَرُونَ ﴿٣٠﴾

31. Andaj, toleroji ata dhe prit (vendimin e Zotit); sigurisht, edhe ata janë në pritje.

فَاعْرِضْ عَنْهُمْ وَأَنْتَظِرُ إِنَّهُمْ  
مُنْتَظَرُونَ ﴿٣١﴾

## Surja 33 – El-Ahzab

Surja El-Ahzab është medinase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka shtatëdhjetë e katër ajete.

Që në fillim të kësaj sureje mbartet tema e ajetit të fundit të sures paraardhëse, pra, Profetit<sup>savs</sup> i thuhet: Mohuesit dhe hipokritët do të tentojnë të të largojnë nga besimi yt, andaj, toleroju, mos iu bind atyre dhe ndiq vetëm atë që të shpallet ty.

Ajeti nr. 5 tregon parimin që njeriu nuk mund të ketë dashuri në të njëjtën masë me dy njerëz njëkohësisht. Kjo tregon se zemra e Profetit<sup>savs</sup> është e pushtuar nga dashuria ndaj Allahut dhe se dashuria e tij për botën dhe për njerëzit e kësaj bote, janë për shkak të dashurisë së tij për Allahun e Madhërishëm. Profeti<sup>savs</sup> vetë tha njëherë: Nëse i fut në gojë një kafshatë buke gruas sate për hir të dashurisë ndaj Allahut, edhe për këtë gjest do të shpërblehesh prej Zotit. (Buhari, nr. 56). Pra, në këtë mënyrë edhe kjo vepër bëhet *ibadet* (adhurim ndaj Allahut).

Pas kësaj, surja flet për një zakon të arabëve, të cilët bashkëshorteve të tyre u drejtoshin duke i quajtur “nëna” për t’u ndarë me to. Allahu i Madhërishëm e dënon këtë zakon duke theksuar se lidhja nënë e bir vendoset sipas ligjit që ka caktuar Allahu dhe ju (o arabë), nuk mund ta tjetërsoni këtë lidhje me fjalë goje tuajat. Po kështu, Zoti thotë: nëse birësoni dikë, ai nuk bëhet biri juaj i vërtetë, sepse biri juaj është ai që është lindur nga gjaku juaj, dhe se të thërrisni dikë si bir, nuk është asgjë tjetër veçse një shprehje dashurie.

Më pas përsëritet e njëjta temë në një aspekt tjetër dhe thuhet se zemra e njeriut mund të dojë më së shumti vetëm një njeri, dhe për sa u përket besimtarëve, ata duhet ta ruajnë këtë pozitë për të Dërguarin e Allahut<sup>savs</sup>, dhe pas tij, për farefisin sipas radhës, të cilët për shkak të lidhjes së gjakut, gëzojnë të drejtën e sjelljes së afrimitetit.

Në këtë sure ku vjen edhe ajeti për Vulën e Profetëve (*Khātemun-nebijjīn*), të cilin disa dijetarë pa pasur njohjen e duhur, nxjerrin kuptimin se Profeti Muhammed<sup>savs</sup>, është profeti i fundit në kuptimin se pas tij nuk ka më asnjë lloj profeti, kjo sure, që në fillimet e saj, e hedh poshtë këtë ide. Ajo përmend besëlidhjen (*mithak*), të cilën Allahu i Madhërishëm e bën me çdo Profet duke u kërkuar: nëse vjen një profet pas jush, i cili vërteton fjalët tuaja, *umeti* (populli) juaj nuk duhet ta mohojë dhe duhet ta mbështesë atë [3:82]. Në këtë sure, duke shtuar fjalët “*ve minke*” (*edhe prej teje*), pohohet se Allahu i Madhërishëm këtë besëlidhje e ka bërë edhe me Profetin Muhammed<sup>savs</sup>. Pra, do të thotë se edhe *umeti* i Profetit Muhammed<sup>savs</sup> është ngarkuar me detyrën që nëse vjen një profet me kushtin që ai të ketë vulën e Profetit s.a.v.s, pra të jetë ndjekës dhe shërbëtor i tij, profetërinë e tij ta ketë për shkak të bekimit të Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, të paraqesë dhe të përhapë pikërisht mësimet e tij duke mos i ndryshuar aspak, dhe të përpiqet për të vijuar misionin e tij, atëherë muslimanët jo vetëm që e kanë të ndaluar ta kundërshtojnë atë, përkundrazi, e kanë për detyrë mbështetjen dhe përkrahjen e tij.

Pas kësaj, duke iu referuar emrit të kësaj sureje El-Ahzab (grupet), surja hedh dritë mbi betejën e Hendekut, në të cilën të gjitha grupet e arabëve u dyndën drejt Medinës për të sulmuar muslimanët. Në një kohë të tillë, Allahu i Madhërishëm bëri mrekullinë duke dërguar një furtunë të llahtarshme, e cila ua verboi sytë mohuesve dhe ata u çorientuan dhe u arratisën në atë gjendje që nuk patën mundësinë as të çlidhnin kafshët e tyre. Kështu që, lanë pas pajimet dhe sendet e tyre në sasi të mëdha, gjë që do t'ua largonte muslimanëve gjendjen e rëndë të urisë që i kishte kapluar nga një kohë e gjatë.

Para se të tregonte ngjarjen e mësipërme, kjo sure shpalosi edhe gjendjen e banorëve të Jethribit (Medinës). Ata shikonin llahtarinë me sytë e tyre dhe ishin kaq të frikësuar, saqë e shihnin vdekjen me sy, kurse hipokritët u thoshin muslimanëve: “Nuk keni më asnjë strehë!” Atëherë muslimanët iu përgjigjën: Neve na është shtuar besimi edhe më shumë, sepse na ishte dhënë kohë më parë profecia e këtij sulmi të grupeve të bashkuara. Ata i referoheshin profecisë që përmendet në ajetin:

*“Aleanca (e armiqve) do të thyhet dhe do të marrë arratinë.”* (54:46).

Kështu që, në këtë betejë, besimtarët e plotësuan premtimin e tyre, por prej tyre ishin edhe të tillë që nuk kishin marrë pjesë në të, por prisnin që atyre t'u jepej mundësia e pjesëmarrjes, që edhe ata të rrëfenin besnikërinë e tyre me Profetin Muhammed<sup>savs</sup>, duke u sakrifikuar në këtë rrugë.

Ajeti nr. 38 i kësaj sureje i sjell Profetin Muhammed<sup>savs</sup>, urdhrin që ai të martohej me të divorcuarën e *Hazret Zejdit<sup>ra</sup>*, të cilin Profeti<sup>savs</sup> dikur e kishte birësuar. Zbatimi i këtij urdhri ishte shumë i vështirë për Profetin<sup>savs</sup>. Ndoshta ai kishte pak frikë edhe nga akuzat që do të ngrinin hipokritët, megjithatë, nuk mund ta shmange dot urdhrin e Allahut të Madhërishëm.

Pas kësaj vjen një ajet (ajeti nr. 41), për të cilin mund të themi se është maja e kësaj sureje. Ajeti në fjalë, ndër të tjera, lidhet edhe me ngjarjen e *Hazret Zejdit<sup>ra</sup>*. Profeti Muhammed<sup>savs</sup>, jo vetëm që nuk ka qenë babai i Zejdit<sup>ra</sup>, madje u shpall që ai nuk është dhe nuk do të jetë babai i askujt prej meshkujve si ju, por ai është Vula e Profetëve (*Khātemun-nebījīn*). Pra, ai gëzon statusin për të qenë babai shpirtëror i Profetëve. Ky është kuptimi që na jep konteksti, por nuk është i vetmi. Ka shumë kuptime të tjera që janë të lidhura ngushtë me këtë ajet madhështor dhe, në çdo kuptim, Profeti Muhammed<sup>savs</sup> vërtetohet si Vula e Profetëve. Për shembull, një kuptim i fjalës “khatem” (vula) në arabisht është edhe “vërtetues”. Ndër të gjithë Librat qiellorë, është vetëm Sheriati i Profetit<sup>savs</sup> (Kurani i Shenjtë), i cili vërtetoi vërtetësinë e Profetëve të mëparshëm dhe vërtetësinë e Profetëve të të gjitha kohërave. Asnjë fe tjetër e botës nuk mund të paraqesë një ajet (varg) kaq madhështor si ky.

Ajeti vijues na çon vëmendjen te lutja e *Hazret Zekerijasë<sup>ra</sup>*, i cili pasi pati lajmin e mirë të lindjes së një djali, mori shpalljen prej Zotit: “Përkujtoni Zotin në mëngjes e në mbrëmje”.

Më pas, ajetet 46 e 47, pohojnë se Profeti Muhammed<sup>savs</sup> është Dëshmitar, Si-hariqdhënës dhe Alarmues. Profeti<sup>savs</sup> është Dëshmitar i vërtetësisë së *Hazret Musait<sup>as</sup>*, Profeti më madhështor përpara tij, si dhe ai është Dëshmitar edhe për vërtetësinë e shërbëtorit të tij që do të vinte në *umetin* e tij. Shembulli i madhështisë së tij është krahasuar me diellin, i cili ndriçon të gjithë planetët dhe, edhe hëna prej atij ndriçohet. Kështu që, ishte e caktuar se një hënë do të rrezatonte dritën e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, për të ndriçuar njerëzit në kohëra të errëta që ngjasojnë me natën. Prandaj, ky ajet ka një profeci se kështu do të ndodhë në të ardhmen.

Pas kësaj, kjo sure u mëson besimtarëve etikën dhe *takvanë* duke ua shpjeguar pozitën e lartë të Profetit Muhammed<sup>savs</sup> dhe respektin e madh që ata duhet të kenë ndaj tij. I Dërguari i Allahut<sup>savs</sup>, herë pas here, ftonte në shtëpinë e tij të afërmit dhe shokët (sahabët) e tjerë. Këto ajete i porosisin sahabët që ata nuk duhet të trajtojnë ftesën e të Dërguarit të Allahut<sup>savs</sup> sikur ftesat e njerëzve të tjerë, ku mund të shkosh edhe para kohe dhe pret derisa të gatuhet e të shtrohet buka. Madje, ata duhet të kenë parasysh kohën e çmuar të të Dërguarit të Allahut<sup>savs</sup>, dhe të shkojnë vetëm atëherë kur të thirren, dhe pas buke, t'i marrin leje për t'u kthyer. Gjithashtu, nëse kanë nevojë për diçka gjatë bukës dhe për këtë duan të komunikojnë me bashkëshortet e Profetit, pra me nënat e besimtarëve, të komunikojnë mbrapa perdes. Ky mësim i pastërtisë shpirtërore, në këto ajete, iu është dhënë në mënyrë më të theksuar bashkëshorteve të Profetit<sup>savs</sup>, sesa sahabëve të tij, pasi pozita e tyre e lartë kërkon që ata të mos lejojnë asnjë lloj akuze a njollosje mbi nderin e pastër të të Dërguarit të Allahut<sup>savs</sup>.

Hipokritët ashtu siç e kishin bërë Profetin Muhammed<sup>savs</sup> shënjestër të akuzave të tyre, në të njëjtën mënyrë, edhe *Hazret Musain<sup>as</sup>* e kishin shqetësuar gjatë jetës së tij. Andaj, në fund të kësaj sureje vihen në dukje ngjashmëri të shumta që këta dy Profetë madhorë kanë me njëri-tjetrin. Duke e çliruar nga akuzat, Zoti i Madhërisëm tha për *Hazret Musain<sup>as</sup>* se ai pa dyshim është i nderuar (*vexhih*) në sytë e Tij. Kështu kuptohet që edhe për Profetin Muhammed<sup>savs</sup>, Zoti thotë se ai nuk duhet të shqetësohej aspak për akuza të tilla dhe se tek Allahu i Madhërisëm ai është i nderuar në këtë botë dhe në *ahiret*.

Dy ajetet e fundit të kësaj sureje sërish i referohen edhe *Hazret Musait<sup>as</sup>*, pasi barra e amanetit me të cilën është ngarkuar Profeti Muhammed<sup>savs</sup>, është shumë më e madhe sesa barra e përgjegjësisë që i ishte besuar *Hazret Musait<sup>as</sup>*. Peshë e përgjegjësisë së Profetit Muhammed<sup>savs</sup> është aq e madhe, saqë edhe malet do të thërrmoheshin nga frika përpara saj, por Zoti thotë për Profetin<sup>savs</sup>: ti dole përpara për ta marrë këtë përgjegjësi, dhe si rrjedhojë u detyrove të privoje veten nga shumë të drejta, por duke u treguar vetëmohues i plotë, nuk u shqetësove se me çfarë pasojash do të përballeshe në të ardhmen.





1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. O Profet! Ki druajtjen ndaj Allahut dhe mos ndiq mohuesit dhe hipokritët. Pa dyshim, Allahu është i Gjithëdijshëm, i Urtë.

يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ اتَّقِ اللَّهَ وَلَا تُطِعِ الْكَافِرِينَ  
وَالْمُنَافِقِينَ ۗ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلِيمًا حَكِيمًا ①

3. Ndiqe atë që të shpallet ty prej Zotit tënd. Pa dyshim, Allahu është i Gjithinformuar për atë që bëni.

وَاتَّبِعْ مَا يُوحَىٰ إِلَيْكَ مِنْ رَبِّكَ ۗ إِنَّ اللَّهَ  
كَانَ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرًا ①

4. Dhe mbështetu tek Allahu. Allahu është i mjaftueshëm si Mbrojtës.

وَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ ۗ وَكَفَىٰ بِاللَّهِ وَكِيلًا ①

5. Allahu nuk bëri për ndonjë njeri dy zemra në gjoksin e tij. Po kështu, gratë tuaja që ju i bëni të ndaluara për vete duke i quajtur nëna, Ai nuk i ka bërë nëna për ju. As të birësuarit tuaj nuk i ka bërë djem tuajt. Këto janë fjalë goje tuajat, kurse Allahu thotë të vërtetën dhe është pikërisht Ai që tregon rrugën (e drejtë).

مَا جَعَلَ اللَّهُ لِرَجُلٍ مِّنْ قَلْبَيْنِ فِيْ جَوْفِهِ ۚ  
وَمَا جَعَلَ أَرْوَاجَكُمْ الَّتِي تُظْهِرُونَ مِنْهُنَّ  
أُمَّهَاتِكُمْ ۗ وَمَا جَعَلَ أَدْعِيَاءَكُمْ أَبْنَاءَكُمْ ۗ  
ذِكْرُكُمْ قَوْلُكُمْ بِأَفْوَاهِكُمْ ۗ وَاللَّهُ يَقُولُ  
الْحَقَّ وَهُوَ يَهْدِي السَّبِيلَ ①

6. Thirrini ata në emër të baballarëve të tyre, kjo është më e drejtë tek Allahu. E nëse nuk i dini baballarët e tyre, atëherë ata janë vëllezërit e shokët tuaj në besim. Nuk është gjynah mbi ju për atë që gabuat në lidhje me këtë, por (keni faj) për atë që zemrat tuaja e kanë bërë me qëllim. Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

أَدْعُوهُمْ لِأَبَائِهِمْ هُوَ أَفْطَرُ عِنْدَ اللَّهِ ۚ  
فَإِنْ لَّمْ تَعْلَمُوا آبَاءَهُمْ فَاخْوَانُكُمْ فِي  
الدِّينِ وَمَوَالِيكُمْ ۗ وَلَيْسَ عَلَيْكُمْ جُنَاحٌ  
فِيمَا أَخْطَأْتُمْ بِهِ ۗ وَلَكِنْ مَّا تَعَمَّدَتْ  
قُلُوبُكُمْ ۗ وَكَانَ اللَّهُ غَفُورًا رَّحِيمًا ①

7. Profeti ka të drejtë mbi besimtarët më shumë sesa jeta e tyre, dhe bashkëshortet e tij janë nënat e tyre. Për sa u përket lidhjeve të gjakut, ata kanë përparësi ndaj njëri-tjetrit (siç është e shkruar) në Librin e Allahut, në krahasim me besimtarët dhe muhaxhirët (e tjerë). Po, mund të bëni mirësi ndaj shokëve tuaj sipas rregullit. (E gjithë) kjo është e shkruar në Libër.

8. Dhe (kujtoni) kur Allahu mori prej Profetëve besëlidhjen e tyre dhe prej teje, prej Nuhut, Ibrahimit, Musait, Isait birit të Merjemes. Ne morëm prej tyre një besëlidhje të fortë.<sup>1</sup>

9. Që Ai t'i pyesë të vërtetët për vërtetësinë e tyre. Dhe për mohuesit Ai ka përgatitur ndëshkim të dhimbshëm.

10. O ju që besuat! Kujtoni bekimin e Allahut mbi ju, kur ju erdhën ushtritë, atëherë Ne dërguam kundër tyre një erë dhe ushtri (të tilla), që ju nuk i shikonit.<sup>2</sup> Allahu sheh mirë atë që bëni.

الَّتِي أُولَىٰ بِالْمُؤْمِنِينَ مِنْ أَنْفُسِهِمْ  
وَأَزْوَاجَهُ أُمَّهَاتُهُمْ وَأُولَئِذَا الْأَرْحَامِ بَعْضُهُمْ  
أَوْلَىٰ بِبَعْضٍ فِي كِتَابِ اللَّهِ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ  
وَالْمُهَاجِرِينَ إِلَّا أَنْ تَفْعَلُوا إِلَىٰ أَوْلِيَائِكُمْ  
مَعْرُوفًا كَانَ ذَلِكَ فِي الْكِتَابِ مَسْطُورًا ﴿٧﴾

وَإِذْ أَخَذْنَا مِنَ النَّبِيِّينَ مِيثَاقَهُمْ وَمِنْكَ  
وَمِنْ نُوحٍ وَإِبْرَاهِيمَ وَمُوسَىٰ وَعِيسَى ابْنِ  
مَرْيَمَ وَأَخَذْنَا مِنْهُمْ مِيثَاقًا غَلِيظًا ﴿٨﴾

لِيَسْأَلَ الصَّادِقِينَ عَنْ صِدْقِهِمْ وَأَعَدَّ  
عَذَابًا لِّلْكَافِرِينَ عَذَابًا أَلِيمًا ﴿٩﴾

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا أَذْكُرُوا نِعْمَةَ اللَّهِ  
عَلَيْكُمْ إِذْ جَاءَكُمْ جُودٌ فَأَرْسَلْنَا عَلَيْهِمْ  
رِيحًا وَجُودًا لَّمْ تَرَوْهَا وَكَانَ اللَّهُ بِمَا  
تَعْمَلُونَ بَصِيرًا ﴿١٠﴾

1. Besëlidhja që Allahu e mori prej Profetëve është ajo që përmendet në Kuranin e Shenjtë në suren Ali Imran, ku thuhet: "Kur Allahu mori besëlidhjen nga profetët: "Kurdo që t'ju vijë ndonjë i dërguar, pasi ju kam dhënë diçka nga Libri dhe urtësia, dhe ai të jetë vërtetues i asaj që ju e keni, duhet ta besoni dhe duhet ta ndihmoni atë". Tha: "A e pranoni dhe lidhni me Mua besën për këtë gjë?" Ata thanë: "E pranojmë". Ai tha: "Jini dëshmitarë, edhe Unë do të jem dëshmitar bashkë me ju!" (3:82).

2. Ajeti flet për betejën e Hendekut, kur pikërisht ditën kur armiku kishte shpresë se do ta bënte sulmin triumfues, filloi furtuna. Gjatë natës, atyre iu shuan zjarret që ata mbanin, gjë që e quajtën ogurzezë, dhe kjo më pas shkaktoi kaos në të gjithë kampin e tyre. Komandantët e tyre u detyruan të iknin sa më parë me gjithë fiset. Kështu Allahu i shpëtoi muslimanët nga sulmi i tyre.

11. Kur ata ju erdhën edhe nga lart dhe edhe nga poshtë, dhe kur juve ju u errësuan sytë, dhe zemrat ju erdhën në fyt, dhe po mendonit ndryshe rreth Allahut;<sup>3</sup>

إِذْ جَاءُوكُم مِّن فَوْقِكُمْ وَمِنْ أَسْفَلَ مِنكُمْ وَإِذْ زَاغَتِ الْأَبْصَارُ وَبَلَغَتِ الْقُلُوبُ الْحَنَاجِرَ وَتَظُنُّونَ بِاللَّهِ الظُّنُونًا ۝

12. atje u sprovuan besimtarët dhe u tronditën jashtëzakonisht fort.

هُنَالِكَ ابْتُلِيَ الْمُؤْمِنُونَ وَزُلْزِلُوا زِلْزَالًا شَدِيدًا ۝

13. Dhe kur hipokritët dhe ata që kanë pasur “sëmundje” në zemër, zunë të flisnin: “Allahu dhe i Dërguari i Tij nuk na kanë premtuar asgjë tjetër përveç mashtrimit!”

وَإِذْ يَقُولُ الْمُنَافِقُونَ وَالَّذِينَ فِي قُلُوبِهِمْ مَّرَضٌ مَا وَعَدَنَا اللَّهُ وَرَسُولُهُ إِلَّا غُرُورًا ۝

14. Dhe kur një grup prej tyre tha: “O banorët e Jethribit!<sup>4</sup> Kthehuni se nuk ka strehë për ju!” Dhe një grup prej tyre i kërkoi leje Profetit duke thënë: “Shtëpitë tona kanë mbetur të pambrojtura!”<sup>5</sup>, por ato nuk ishin të pambrojtura; ata vetëm donin të iknin.

وَإِذْ قَالَتْ طَائِفَةٌ مِّنْهُمْ يَا أَهْلَ يَثْرِبَ لَا مَقَامَ لَكُمْ فَارْجِعُوا ۚ وَيَسْتَأْذِنُ فَرِيقٌ مِّنْهُمْ النَّبِيَّ يَقُولُونَ إِنَّ بُيُوتَنَا عَوْرَةٌ ۗ وَمَا هِيَ بِعَوْرَةٍ إِنَّ يُرِيدُونَ إِلَّا فِرَارًا ۝

15. Nëse do të hynin (ushtritë në qytet) nga të gjitha anët e tij për t’i sulmuar ata, e më pas t’u kërkohet tradhtia, ata patjetër do ta bënë anë dhe nuk do të prisnin gjatë.

وَلَوْ دَخَلَتْ عَلَيْهِمْ مِّنْ أَقْطَارِهَا ثُمَّ سَأَلُوا الْفِتْنَةَ لَآتَوَّهَا وَمَا تَلَبَّثُوا بِهَا إِلَّا لَيْسِيرًا ۝

16. Ndërkohë përpara (kësaj) ata i kishin premtuar Allahut se nuk do t’ia kthenin shpinën dhe për premtimin

وَلَقَدْ كَانُوا عَاهَدُوا اللَّهَ مِنْ قَبْلُ لَا يُوَلُّونَ

3. “ata erdhën nga lart” do të thotë nga jashtë. Pra ushtritë e bashkuara të mohuesve që e kishin rrethuar Medinën. “Nga poshtë” do të thotë nga brenda Medinës, që ishin ata hebrenj të cilët e shkelën marrëveshjen dhe krijuan aleancë me armikun që qëndronte jashtë.

4. Jethrib është emri i vjetër i Medinës.

5. Për këtë kuptim të fjalës ‘aureh, shikoni fjalorin *Mufredat i Imam Ragibit*<sup>a</sup>.

e bërë ndaj Allahut, do të kërkohet llogari.<sup>6</sup>

17. Thuaj: Nëse (doni) të ikni nga vdekja ose vrasja, ikja kurrsesi nuk do t'ju bëjë dobi. Në këtë rast, ju nuk do të përfitonit dot, por shumë pak.

18. Pyeti: “Cili është ai që do t'ju mbrojë nga Allahu, nëse Ai do që t'ju lëndojë ose do që t'ju tregojë mëshirë?!” Ata nuk do të gjejnë dot përveç Allahut as kujdestar e as ndihmës.

19. Allahu i di mirë ndaluesit (nga xihadi) prej jush dhe (i di edhe) ata që u thonë vëllezërve të tyre: “Ejani te ne!” Ata nuk vijnë në luftë, me përjashtim të një pakice.

20. Janë shumë koprracë ndaj jush. E kur u vjen frika, do t'i shohësh që ata janë duke të parë ty me sytë e tyre të zgurdulluar, porsia ai të cilin e pushton vdekja. E kur u largohet frika, ju lëndojnë me gjuhët e tyre të mprehta, duke u treguar koprracë në mirësi. Këta janë ata që (në fakt) nuk kanë besuar. Andaj, Allahu ua zhvlerësoi veprat; dhe kjo për Allahun është e lehtë.

الْأَذْبَارُ ۖ وَكَانَ عَهْدُ اللَّهِ مَسْئُولًا ﴿١٧﴾

قُلْ لَنْ يَنْفَعَكُمْ الْفِرَارُ إِنْ فَرَرْتُمْ مِنَ الْمَوْتِ أَوِ الْقَتْلِ وَإِذَا لَا تُمْتَعُونَ إِلَّا قَلِيلًا ﴿١٧﴾

قُلْ مَنْ ذَا الَّذِي يَعْصِمُكُمْ مِنَ اللَّهِ إِنْ أَرَادَكُمْ سُوءًا أَوْ أَرَادَ بِكُمْ رَحْمَةً ۗ وَلَا يَجِدُونَ لَهُمْ مِنْ دُونِ اللَّهِ وَلِيًّا وَلَا نَصِيرًا ﴿١٨﴾

قَدْ يَعْلَمُ اللَّهُ الْمُعَوِّقِينَ مِنْكُمْ وَالْقَائِلِينَ لِإِخْوَانِهِمْ هَلُمَّ إِلَيْنَا ۚ وَلَا يَأْتُونَ الْبَاسَ إِلَّا قَلِيلًا ﴿١٩﴾

أَشْحَاءَ عَلَيْكُمْ ۚ فَإِذَا جَاءَ الْخَوْفُ رَأَيْتَهُمْ يَنْظُرُونَ إِلَيْكَ تَدْوُرُ أَعْيُنُهُمْ كَالَّذِي يُغْشَى عَلَيْهِ مِنَ الْمَوْتِ ۚ فَإِذَا ذَهَبَ الْخَوْفُ سَلَقُوكُمْ بِاللِّسَانِ حِدَادٍ أَشْحَاءَ عَلَى الْخَيْرِ ۗ أُولَٰئِكَ لَمْ يُؤْمِنُوا فَأَحْبَطَ اللَّهُ أَعْمَالَهُمْ ۗ وَكَانَ ذَٰلِكَ عَلَى اللَّهِ يَسِيرًا ﴿٢٠﴾

6. I referohet marrëveshjes së tyre (pra, të hebrenjve), që ata e lidhën me muslimanët e Medinës, se do të luftonin përkrah tyre, në rast se ndonjë armik do t'i sulmonte muslimanët në Medinë.

21. Ata mendojnë se ushtritë akoma nuk janë larguar. Nëse ushtritë kthehen, ata do të donin (dëshpërimisht) të jetonin nëpër shkretëtira në mesin e beduinëve dhe (nga atje) të kërkonin lajmet tuaja. Nëse do të ishin mes jush, ata do të luftonin, por shumë pak.

يَحْسَبُونَ الْأَحْزَابَ لَمْ يَذْهَبُوا وَإِنْ يَأْتِ  
الْأَحْزَابَ يَوَدُّوْنَ لَوْ أَنَّهُمْ بَادُونَ فِي  
الْأَعْرَابِ يَسْأَلُونَ عَنْ أَنْبَائِكُمْ ۖ وَلَوْ كَانُوا  
فِيكُمْ مَا قَاتَلُوا إِلَّا قَلِيلًا ۝

22. Sigurisht, për ju në të Dërguarin e Allahut ka një model të shkëlqyer, për çdokënd që shpreson Allahun dhe Ditën e *Ahiretit* dhe kujton shumë Allahun.<sup>7</sup>

لَقَدْ كَانَ لَكُمْ فِي رَسُولِ اللَّهِ أُسْوَةٌ حَسَنَةٌ  
لِّمَن كَانَ يَرْجُوا اللَّهَ وَاليَوْمَ الْآخِرَ  
وَذَكَرَ اللَّهَ كَثِيرًا ۝

23. E kur besimtarët i panë ushtritë, thanë: “Kjo është ajo që na kishin premtuar Allahu dhe i Dërguari i Tij, dhe Allahu dhe i Dërguari i Tij kishin

وَلَمَّا رَأَى الْمُؤْمِنُونَ الْأَحْزَابَ لَّ قَالُوا هَذَا  
مَا وَعَدَنَا اللَّهُ وَرَسُولُهُ وَصَدَقَ اللَّهُ  
وَ رَسُولُهُ ۖ وَمَا زَادَهُمْ إِلَّا إِيمَانًا وَ

7. Në mesin e muslimanëve ka shumë që dëshirojnë të arrijnë lartësitë shpirtërore përmes ushtrimeve apo faljeve që ata kanë sajuar vetë, por ajo metodë që i Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> nuk e ka ndjekur, është e kotë. Kush mund të jetë njeriu më me përvojë sesa vetë Profeti Muhammed<sup>savs</sup> për sa i përket ndjekjes së rrugës së atyre të cilët Zoti i ka bekuar?! Madje, është pikërisht ai tek i cili janë përsosur të gjitha lartësitë dhe pozitat e profetërisë. Andaj, rruga që ai e ka ndjekur, është më e mira dhe më e sakta. Çdo rrugë tjetër, sado e bukur dhe përgëzuese të mund t’ju duket, ju çon në humbje. Nëse e ndjek Profetin Muhammed<sup>savs</sup> me sinqeritetin e plotë, ti e gjen Zotin. Por nëse dikush kryen falje gjithë jetën, duke e lënë rrugën e Profetit<sup>savs</sup>, nuk mund ta arrijë dot qëllimin.

Këtu duhet sqaruar edhe një gjë tjetër. Ndjekja e sunetit ose e praktikës së Profetit<sup>savs</sup> është shumë e rëndësishme, sepse suneti është ai që Profeti e ka bërë për të shpjeguar porosinë e Kuranit të Shenjtë. Për shembull, në Kuranin e Shenjtë nuk shohim numrin e rekateve të namazeve të pesë vakteve, pra që sa rekate ka namazi i sabahut dhe namazet e tjera me radhë. Por suneti ka qartësuar çdo gjë. Nuk duhet ngatërruar suneti me hadithet, pasi nuk janë të njëjta. Hadithet janë mbledhur njëqind a njëqind e pesëdhjetë vjet më vonë, ndërsa suneti ka ekzistuar bashkë me Kuranin e Shenjtë. Për shembull, përpara se të grumbulloheshin hadithet, njerëzit falnin namaz, jepnin zekat, bënin haxh dhe dinin çka është hallall dhe çka është haram. Po, edhe hadithet janë të rëndësishme sepse sqarojnë shumë nga çështjet e historisë, të moralit dhe të *fikhut* të Islamit. Një dobi e madhe e hadithit është që ai është në shërbim të Kuranit dhe të sunetit. Në këtë aspekt, hadithi përbën një thesar të çështjeve islame. Prandaj, mosvlerësimi i hadithit është gjymtim i një pjese të Islamit. Por nuk është i denjë të pranohet ai “hadith” që është kundër Kuranit dhe sunetit, ose që është kundër një hadithi tjetër që përputhet me Kuranin.

thënë të vërtetën” e kjo ua shtoi atyre vetëm besimin dhe bindjen.

تَسْلِيمًا ۝

24. Ka burra prej besimtarëve që vërtetuan atë që i kishin premtuar Allahut. Pra, prej tyre ka nga ata që e arritën synimin, dhe prej tyre ka edhe nga ata që po presin dhe ata nuk ndryshuan aspak (mendimin e tyre).<sup>8</sup>

مِنَ الْمُؤْمِنِينَ رِجَالٌ صَدَقُوا مَا عَاهَدُوا اللَّهَ عَلَيْهِ فَمِنْهُمْ مَّنْ قَضَىٰ نَحْبَهُ وَمِنْهُمْ مَّنْ يَنْتَظِرُ ۖ وَمَا بَدَّلُوا تَبْدِيلًا ۝

25. (Kjo ndodhi) që Allahu t'i shpërblejë të vërtetët për vërtetësinë e tyre dhe të ndëshkojë hipokritët, nëse do, ose t'ua pranojë pendesën duke i mëshiruar. Pa dyshim, Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

لِيَجْزِيَ اللَّهُ الصَّادِقِينَ بِصِدْقِهِمْ وَيُعَذِّبَ الْمُنَافِقِينَ إِنْ شَاءَ أَوْ يَتُوبَ عَلَيْهِمْ ۗ إِنَّ اللَّهَ كَانَ غَفُورًا رَّحِيمًا ۝

26. Dhe ata që mohuan, Allahu i ktheu bashkë me zemëratën e tyre (në atë mënyrë që), ata nuk patën asnjë të mirë. Allahu iu mjaftua besimtarëve në luftë dhe Allahu është shumë i Fuqishëm, Triumfues.

وَرَدَّ اللَّهُ الَّذِينَ كَفَرُوا بِعَيْظِهِمْ لَمْ يَأْلُوا حَيْرَاتٍ ۖ وَكَفَىٰ اللَّهُ الْمُؤْمِنِينَ الْقِتَالَ ۖ وَكَانَ اللَّهُ قَوِيًّا عَزِيمًا ۝

27. Dhe prej ithtarëve të Librit ata që i ndihmuan këta (mohues), Ai i zbriti nga kështjellat e tyre dhe futi frikë në zemrat e tyre. Një pjesë të tyre ju i vratë, dhe një pjesë tjetër i robëruat.<sup>9</sup>

وَأَنْزَلَ الَّذِينَ ظَاهَرُوهُمْ مِّنْ أَهْلِ الْكِتَابِ مِنْ صَيَاصِيهِمْ وَقَذَفَ فِي قُلُوبِهِمُ الرُّعْبَ فَرِيقًا تَقْتُلُونَ وَتَأْسِرُونَ فَرِيقًا ۝

8. Pas këtij ajeti, nëse dikush tenton t'i prishë këto dëshmi, me fjalë të tjera ai tenton ta prishë profetërinë e Pejgamberit<sup>savs</sup>. Andaj, Pejgamberin<sup>savs</sup> mund ta vlerësojë siç duhet vetëm ai, që i vlerëson edhe sahabët e tij të nderuar. E ai që nuk i nderon sahabët, nuk e nderon as të Dërguarin e Allahut<sup>savs</sup> dhe do të jetë gënjeshtar në deklaratën e tij se e do të Dërguarin e Allahut<sup>savs</sup>, sepse nuk është e mundur të kesh dashuri për Profetin<sup>savs</sup> dhe urrejtje për sahabët<sup>ra</sup>. Lexoni edhe 58:23.

9. Ajeti flet për ata hebrenj, të cilët i tradhtuan muslimanët në betejën e Hendekut. Ndonëse ata jetonin në kështjella të forta, fortesat e tyre nuk i shpëtuan dot kur Allahu i Madhërisëm

28. Dhe (Allahu) ju trashëgoi tokat, shtëpitë dhe pasuritë e tyre, si dhe një tokë (tjetër) që ju nuk e kishit shkelur deri atëherë.<sup>10</sup> Allahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë.

وَأَوْرَثَكُمْ أَرْضَهُمْ وَدِيَارَهُمْ وَأَمْوَالَهُمْ  
وَأَرْضًا لَمْ تَطَّوُّهَا<sup>ط</sup> وَكَانَ اللَّهُ عَلَى كُلِّ  
شَيْءٍ قَدِيرًا<sup>٢٨</sup>

29. O Profet! Thuaju bashkëshorteve të tua: “Nëse doni jetën e kësaj bote dhe bukurinë e saj, ejani t’ju pasuroj dhe t’ju bëj lamtumirë në mënyrë të bukur.<sup>11</sup>

يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ قُلْ لِّأَزْوَاجِكِ إِن كُنْتُنَّ  
تُرِيدْنَ الْحَيَاةَ الدُّنْيَا وَزِينَتَهَا فَتَعَالَيْنَ  
أُمْتِعْكَنَّ وَاسْرِّحْكَنَّ سَرَاحًا جَمِيلًا<sup>٢٩</sup>

30. Dhe nëse doni Allahun, të Dërguarin e Tij dhe shtëpinë e *ahiretit*, atëherë për mirëbërëset prej jush Allahu ka përgatitur një shpërblim madhor.<sup>12</sup>

وَإِنْ كُنْتُنَّ تُرِيدْنَ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَالذَّارَ  
الْآخِرَةَ فَإِنَّ اللَّهَ أَعَدَّ لِلْمُحْسِنَاتِ مِنْكُنَّ  
أَجْرًا عَظِيمًا<sup>٣٠</sup>

31. O gratë e Profetit! Prej jush ajo që bën ndonjë paturpësi të hapur, do të ketë dyfishin e ndëshkimit. Dhe kjo është e lehtë për Allahun.

يُنْسَاءُ النَّبِيِّ مَنْ يَأْتِ مِنْكُنَّ بِفَاحِشَةٍ  
مُّبِينَةٍ يُصَعَفْ لَهَا الْعَذَابُ ضِعْفَيْنِ<sup>ط</sup> وَكَانَ  
ذَلِكَ عَلَى اللَّهِ يَسِيرًا<sup>٣١</sup>

32. Prej jush ajo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe bën të mira, Ne do t’ia japim shpërblimin e saj dy herë dhe kemi përgatitur për të një dhuratë të nderuar.

وَمَنْ يَتَّقِ اللَّهَ يَجْعَلْ لَهَا جَازًا مِّمَّا  
كَرِهَتْ وَتُعْطِهَا مِنْ نَحْوِهَا عَظِيمًا<sup>٣٢</sup>

vendosi triumfin e muslimanëve kundër tyre, madje ata me duart e veta i rrëzuan ato [nga dëshpërimi].

10. Përveç fitores së lartpërmendur, kjo pjesë e ajetit bëri profecinë që muslimanët do të fitonin edhe një tokë tjetër që deri atëherë ata as nuk e kishin shkelur. Këto fjalë përbëjnë një varg të gjatë profecish, që do të përmblidhet në të ardhmen.

11. Pavarësisht nga ky lejim, asnjëra nga gratë e Profetit nuk e braktisi Profetin<sup>savs</sup>, gjë që tregon se ato e donin Allahun, të Dërguarin e Tij dhe *ahiretin* dhe se zemrën nuk e kishin lidhur me botën materiale.

12. Në ajetet më sipër u përmendën fitoret e muslimanëve. Kjo natyrisht mund t’i ngjallte ëndërrime ndokujt, po kështu edhe grave, që tani e tutje do të kishin jetë luksi. Andaj, menjëherë pas kësaj, Zoti i Madhërishtëm i përgatiti gratë e Profetit<sup>savs</sup> që jeta e tyre është për të synuar pëlqimin e Zotit dhe botën e përtejme.

33. O gratë e Profetit! Ju nuk jeni sikur gratë e tjera, me kushtin që të keni druajtje (ndaj Allahut), andaj, mos flisni me përkëdheli, që të mos ju lakmojë ai që ka “sëmundje” në zemër, dhe thoni fjalë të mira.

34. Qëndroni në shtëpitë tuaja dhe mos dilni të zbukuruar si në kohën e mëparshme të injorancës, falni namazin, jepni zekatin, bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Pa dyshim, Allahu dëshiron të largojë prej jush papastërtinë, o anëtarët e shtëpisë (së Profetit),<sup>13</sup> dhe t’ju pastrojë plotësisht.

35. Dhe kujtoni ajetet e Allahut dhe urtësinë që lexohet në shtëpitë tuaja. Sigurisht, Allahu është i Mprehtë, i Gjithinformuar.

36. Pa dyshim, muslimanët dhe muslimanet, besimtarët dhe besimtare, të bindurit dhe të bindurat, të vërtetët dhe të vërtetat, durimtarët dhe durimtare, të përlulurit dhe të përlulurat, bamirësit dhe bamirëset, agjëruesit dhe agjërueset, ruajtësit e organeve intime dhe ruajtëset, përkujtuesit e shpeshtë të Allahut dhe përkujtueset; për të gjithë këta Allahu ka përgatitur falje dhe shpërblim madhor.<sup>14</sup>

يُنْسَاءَ النَّبِيِّ لَسْتُنَّ كَأَحَدٍ مِنَ النِّسَاءِ إِنَّ  
أَقْبَبْتُنَّ فَلَا تَخْضَعْنَ بِالْقَوْلِ فَيَطْمَعَ  
الَّذِي فِي قَلْبِهِ مَرَضٌ وَ قُلْنَ قَوْلًا  
مَعْرُوفًا ﴿٣٣﴾

وَقَرْنَ فِي بُيُوتِكُنَّ وَلَا تَبَرَّجْنَ تَبَرُّجَ  
الْجَاهِلِيَّةِ الْأُولَى وَأَقِمْنَ الصَّلَاةَ وَآتِينَ  
الزَّكَاةَ وَأَطِعْنَ اللَّهَ وَرَسُولَهُ إِنَّمَا يُرِيدُ  
اللَّهُ لِيُذْهِبَ عَنْكُمُ الرِّجْسَ أَهْلَ الْبَيْتِ  
وَيُطَهِّرَكُمُ تَطْهِيرًا ﴿٣٤﴾

وَأذْكُرْنَ مَا يُتْلَى فِي بُيُوتِكُنَّ مِنْ آيَاتِ اللَّهِ  
وَ الْحِكْمَةَ إِنَّ اللَّهَ كَانَ لَطِيفًا خَبِيرًا ﴿٣٥﴾

إِنَّ الْمُسْلِمِينَ وَالْمُسْلِمَاتِ وَالْمُؤْمِنِينَ  
وَالْمُؤْمِنَاتِ وَالْقَنَاتِينَ وَالْقَنَاتِ وَالصَّادِقِينَ  
وَالصَّادِقَاتِ وَالصَّابِرِينَ وَالصَّابِرَاتِ وَالْخَشِيعِينَ  
وَالْخَشِيعَاتِ وَالْمُتَصَدِّقِينَ وَالْمُتَصَدِّقَاتِ  
وَالصَّامِينَ وَالصَّامَاتِ وَالْحَفِظِينَ وَالْحَفِظَاتِ  
وَالذَّكِرِينَ وَالذَّكِرَاتِ أَكْثَرَ اللَّهُ كَثِيرًا أَوْ الذَّكِرَاتِ  
أَعَدَّ اللَّهُ لَهُمْ مَغْفِرَةً وَأَجْرًا عَظِيمًا ﴿٣٦﴾

13. Ehli Bejti.

14. Mësimi i Islamit është aq i bukur saqë jo vetëm që i porosit për veprat e mira, si burrat ashtu edhe gratë, madje Vetë Allahu i Madhërisëm ua premtori edhe grave, edhe burrave besimtarë shpërblimin e veprave të tyre. Pra, kushdo prej tyre që i zbaton porositë e Allahut, që i përmbush detyrat e veta për të arritur pastërtinë shpirtërore si dhe detyrat që ka ndaj njerëzve dhe ndaj shoqërisë, do të gëzojë falje dhe shpërblim madhor. Në këtë mënyrë, ky



37. Kur Allahu dhe i Dërguari i Tij vendosin për një çështje, nuk i lejohet as besimtarit e as besimtares të bëjnë zgjedhje të tjera në çështjet e tyre. Ai që kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ka përfunduar në devijim të qartë.

وَمَا كَانَ لِمُؤْمِنٍ وَلَا مُؤْمِنَةٍ إِذَا قَضَى اللَّهُ وَرَسُولُهُ أَمْرًا أَنْ يَكُونَ لَهُمُ الْخِيَرَةُ مِنْ أَمْرِهِمْ ۗ وَمَنْ يَعْصِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ فَقَدْ ضَلَّ ضَلَالًا مُّبِينًا ﴿٣٧﴾

38. Dhe kur i thoshe atij, të cilin Allahu e ka begatuar (dhe) edhe ti e ke begatuar: “Mbaje gruan tënde dhe ki druajtjen ndaj Allahut!”, ti po e fshihje në veten tënde atë që Allahu do ta shfaqte, dhe ti u frikësoheshe njerëzve, kurse Allahu ka më shumë të drejtë t’i frikësohesh Atij. E kur Zejdi përfundimisht u nda prej saj, Ne e martuam atë me ty, që besimtarët të mos kenë më ngurrin në lidhje me gratë e të birësuarve të tyre, pasi (të birësuarit) të ndahen prej tyre. Dhe urdhri i Allahut plotësohet patjetër.<sup>15</sup>

وَإِذْ تَقُولُ لِلَّذِي أَنْعَمَ اللَّهُ عَلَيْهِ وَأَنْعَمْتَ عَلَيْهِ أَمْسِكْ عَلَيْكَ زَوْجَكَ وَاتَّقِ اللَّهَ وَتُخْفِي فِي نَفْسِكَ مَا اللَّهُ مُبْدِيهِ وَتَخْشَى النَّاسَ ۗ وَاللَّهُ أَحَقُّ أَنْ تَخْشَاهُ ۗ فَلَمَّا قَضَىٰ زَيْدٌ مِنْهَا وَطَرًا زَوَّجْنَاكَ بِهَا لِكَيْ لَا يَكُونَ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ حَرَجٌ فِي أَزْوَاجِ أَدْعِيَائِهِمْ إِذَا قَضَوْا مِنْهُنَّ وَطَرًا ۗ وَكَانَ أَمْرُ اللَّهِ مَفْعُولًا ﴿٣٨﴾

ajet shpjegon faktin se si feja Islame i jep status të barabartë si burrit, ashtu edhe gruas. Disa kritikë akuzojnë fenë Islame se ajo bën dallim mes burrit dhe gruas. Po, duke marrë parasysh ndryshimet biologjike të të dyja gjinive, vetë natyra i ka ngarkuar me përgjegjësi të ndryshme, dhe feja Islame që është fe e natyrës njerëzore, u jep porosi të ndryshme përkatëse, në mënyrë që shtëpia të ketë paqe dhe shoqëria njerëzore të jetë e shëndetshme. Lexoni edhe 16:98.

15. Disa të ashtuquajtur dijetarë të krishterë tentojnë të ngrenë akuza të rënda për rastin e martesës së Profetit Muhammed<sup>savs</sup> me Zejneben. Sipas tyre, Profeti, pasi e pa Zejneben rastësisht, u dashurua me të, dhe Zejdi e divorcoi atë, pasi u vu në dijeni për dëshirën e Profetit, *ma’adhAllah*. Fakti që armiqtë më të ashpër të Profetit<sup>savs</sup>, para syve të të cilëve kishte ndodhur kjo martesë, nuk guxuan t’i atribuonin Profetit<sup>savs</sup> motivet e tilla të ulëta, i rrëzon plotësisht akuzat e pabaza të kritikëve që u ngritën pas kaq shumë shekujsh. Zejnebja vinte nga fisi i Profetit<sup>savs</sup>, madje vetë Profeti<sup>savs</sup> e kishte lidhur martesën e saj me Zejdin. Kështu që, Profeti<sup>savs</sup> e kishte parë Zejneben shumë herë përpara se të ndodhte kjo ngjarje. Përveç kësaj, ishte ajo dhe vëllai i saj, të cilët donin që ajo të martohej me Profetin<sup>savs</sup>. Pra, asgjë nuk e pengonte Profetin<sup>savs</sup> të martohej me të që në fillim, kur ajo ishte e virgjër. Profeti<sup>savs</sup> e martoi atë me Zejdin, të cilin dikur e kishte birësuar. Për shkak se Zejdi dhe Zejnebja kishin natyra krejt të ndryshme, martesë në fjalë nuk u zgjat dot. Pas divorcit të tyre, Zoti i Madhërisëm e urdhëroi Profetin<sup>savs</sup> që të martohej me të. Pra, akuza në fjalë është thjesht një pjellë e

39. Profeti nuk duhet të ketë pengesë në (zbatimin) e asaj që Allahu ia ka bërë të obliguar, si praktikë e Allahut që ka qenë (edhe) me ata që ishin më parë. Dhe vendimi i Allahut është i mirëllogaritur.

مَا كَانَ عَلَى النَّبِيِّ مِنْ حَرَجٍ فِيمَا فَرَضَ اللَّهُ لَهُ سُنَّةَ اللَّهِ فِي الَّذِينَ خَلَوْا مِنْ قَبْلُ ۗ وَكَانَ أَمْرُ اللَّهِ قَدَرًا مَقْدُورًا ﴿٣٩﴾

40. (Kjo praktikë e Allahut ka qenë edhe me) ata të cilët përçonin mesazhet e Allahut, Atij i frikësoheshin dhe nuk i frikësoheshin askujt tjetër përveç Allahut. Allahu është i mjaftueshëm për të marrë llogari.

الَّذِينَ يُبَلِّغُونَ رِسَالَاتِ اللَّهِ وَيَخْشَوْنَهُ وَلَا يَخْشَوْنَ أَحَدًا إِلَّا اللَّهَ ۗ وَكَفَى بِاللَّهِ حَسِيبًا ﴿٤٠﴾

41. Muhammedi nuk është babai i askujt prej burrave tuaj, por është i Dërguari i Allahut dhe vula e Profetëve. Allahu është i Gjithëdijshtëm për çdo gjë.<sup>16</sup>

مَا كَانَ مُحَمَّدٌ أَبَا أَحَدٍ مِّن رِّجَالِكُمْ وَلَكِن رَّسُولَ اللَّهِ وَخَاتَمَ النَّبِيِّينَ ۗ وَكَانَ اللَّهُ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمًا ﴿٤١﴾

imagjinatës “pjellore” të armiqve të Profetit Muhammed<sup>savs</sup>.

16. Ajeti thotë: “Muhammedi nuk është babai i askujt prej burrave tuaj, por është i Dërguari i Allahut dhe Vula e Profetëve”. Lidhëza *por* në arabisht, në një fjali siç është ky ajet, vjen për të lidhur dy gjymtyrë të një fjalie ku gjymtyra e parë mohon diçka të caktuar, dhe e dyta e plotëson me diçka tjetër të caktuar. Andaj, pjesa e parë e këtij ajeti i mohon Profetit<sup>savs</sup> një cilësi të caktuar, duke thënë – *ai nuk mund të jetë babai biologjik i asnjë mashkulli*. Më pas me lidhëzën *por*, në pjesën e dytë është shprehur zëvendësimi i cilësisë së mohuar me një cilësi tjetër duke thënë – *ai është i Dërguari i Allahut dhe Vula e Profetëve*. Kuptimi i kësaj është që pas tij nuk ka më profetëri të pavarur; tani e tutje pozitën e profetërisë mund ta marrë vetëm ai që në veprat e tij e ka vulën e ndjekjes së Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, dhe kështu, marrësi i bekimit përmes tij, do të quhet fëmija ose trashëgimtari shpirtëror i Profetit Muhammed<sup>savs</sup>. Shkurt, ky ajet në pjesën e parë ia mohon Profetit cilësinë e të qenit baba biologjik, kurse në pjesën e dytë edhe ia pohon këtë cilësi, por në një formë tjetër. Kjo për ta hedhur poshtë akuzën e mohuesve që përmendet në Kuran që i kishin thënë se është “Profet farësosur” dhe që përmendet edhe në ajetin: “Pikërisht armiku yt do të mbetet farësosur” (108:4). Pra, domethënia e ajetit në komentim është se profetëri të pavarur, qoftë ajo që nuk sjell ndonjë Libër a Sheriat, nuk mund të ketë më kurrë, por një musliman i sinqertë, e gjithë drita e të cilit vjen në saje të dritës së profetërisë së Muhammedit, mund ta gëzojë profetërinë, sepse ai përsoset në radhë të parë si shërbëtor i Profetit Muhammed, dhe pastaj posedon dritën e profetërisë së Muhammedit<sup>savs</sup>. Në qoftë se do t’ia mohosh këtë bekim të përsosmërisë shpirtërore *umetit* të Muhammedit<sup>savs</sup>, rezultat që Profeti Muhammed<sup>savs</sup>, *ma’adhAllah*, është farësosur në të dyja kuptimet, pra që nuk ka as pasardhës biologjik, dhe as atë shpirtëror, dhe në këtë rast, do t’i japësh të drejtën akuzuesve që e quajtën farësosur Profetin Muhammed<sup>savs</sup>.

42. O ju që besuat! Përkujtoni sa më shumë Allahun;

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اذْكُرُوا اللَّهَ ذِكْرًا  
كَثِيرًا ۝٤٢

43. dhe madhërojeni Atë mëngjes e mbrëmje.

وَسَبِّحُوهُ بُكْرَةً وَأَصِيلًا ۝٤٣

44. Është Ai që dërgon paqe mbi ju, gjithashtu (edhe) engjëjt e Tij, që Ai t'ju nxjerrë nga errësirat në dritë. Allahu është shumë Mëshirëbërës ndaj besimtarëve.

هُوَ الَّذِي يُصَلِّيْ عَلَيْكُمْ وَمَلَائِكَتُهُ  
لِيُخْرِجَكُمْ مِنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ ۗ وَكَانَ  
بِالْمُؤْمِنِينَ رَحِيمًا ۝٤٤

45. Ditën kur ata do ta takojnë Atë, përshëndetja për ta do të jetë: “Selam!” dhe Ai u ka përgatitur shpërblim të nderuar.

تَحِيَّاتُهُمْ يَوْمَ يَلْقَوْنَهُ سَلَامٌ ۗ وَأَعَدَّ لَهُمْ  
أَجْرًا كَرِيمًا ۝٤٥

46. O Profet! Pa dyshim, Ne të dërguam ty si dëshmitar, sihariq-dhënës dhe alarmues;

يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ إِنَّا أَرْسَلْنَاكَ شَاهِدًا وَمُبَشِّرًا  
وَنَذِيرًا ۝٤٦

47. dhe si thirrës drejt Allahut me urdhrin e Tij dhe si një diell ndriçues.

وَدَاعِيًا إِلَى اللَّهِ بِأَذْنِهِ وَسِرَاجًا مُنِيرًا ۝٤٧

Nisur nga ky ajet, një pjesë e madhe e muslimanëve pohojnë se “*pas Profetit Muhammed<sup>savs</sup> nuk ka më asnjë profet*”. Po kështu, ata paraqesin hadithe si “*Nuk ka profet pas meje*” (Buhariu, nr. 3455). E megjithatë, presin Hazret Isain<sup>as</sup> të vijë fizikisht prej qiellit dhe gjithashtu presin të dalë edhe Imam Mehdiu. Të dy këta, sipas tyre, do të caktohen prej Zotit dhe se mohimi i tyre do të quhet dalje nga Islami. Pra, në këtë mënyrë, muslimanët e tillë e rrëzojnë vetë pohimin e tyre që bëjnë me këmbëngulje të madhe. Vallë, paska mbaruar profetëria, por nuk paska mbaruar nevoja për të pasur një profet! Për këtë arsye, Hazret Aishja<sup>ra</sup> thoshte: “*Thoni se ai është Vula e Profetëve, dhe mos thoni se nuk ka profet pas tij*” (Xhelaluddin es-Sujuti, “Ed-Durrul-menthur”, nën ajetin 33:41). Përveç kësaj, Hazret Isai<sup>as</sup> që sipas Kuranit ishte Profeti i Zotit për bijtë e Izraelit (3:50), do t’i duhet të marrë “profetëri” të re që të vlejë për *umetin* e Muhammedit<sup>as</sup>. Në këtë mënyrë, ai do ta thyente vulën e Profetëve të Pejgamberit<sup>savs</sup>, sepse ai nuk e ka ndjekur atë asnjë ditë. Për sa i përket kuptimit të hadithit “*nuk ka profet pas meje*”, këtë na e shpjegon një hadith tjetër ku Profeti<sup>savs</sup> thotë: “*Unë jam Profeti i fundit dhe xhamia ime është xhamia e fundit*” (Muslimi, kitab El-Haxh, hadithi 3376). Dihet që janë ndërtuar miliona xhami pas xhamisë së Profetit<sup>savs</sup>, andaj, kuptimi i këtij hadithi është që nuk ka më xhami që nuk është sipas drejtimit të Profetit<sup>savs</sup> dhe po ky kuptim është edhe për pjesën e parë të hadithit që e thamë më lart. Lexoni edhe: 4:70; 33:8; 7:36.

48. Dhe jepu besimtarëve lajmin e mirë që ata do të kenë prej Allahut një bekim të madh.

49. Mos iu bind mohuesve dhe hipokritëve, toleroju lëndimet e tyre e mbështetu tek Allahu. Allahu është i mjaftueshëm si Mbrotjtës.

50. O ju që besuat! Kur martoheni me besimtarët, dhe (nëse) divorcoheni me to përpara se t'i prekni, ato nuk kanë ndonjë afat kohor ndaj jush që ta llogaritni atë. Andaj, jepuni të mira materiale dhe ndahuni me to në mënyrë të denjë.

51. O Profet! Ne të kemi lejuar gratë e tua të cilave ua ke dhënë dhuratën e martesës, si dhe ato që i zotëron ti, pra ato që Allahu t'i ka falur si pre të luftës,<sup>17</sup> po kështu, bijat e xhaxhallarëve të tu, bijat e hallave të tua, bijat e dajave të tu, bijat e tezeve të tua, të cilat mërguan bashkë me ty, dhe grua besimtare nëse ajo dëshiron t'i dhurojë veten Profetit (dhe) nëse Profeti vendos të martohet me të; kjo është vetëm për ty, jo për besimtarët. Ne e dimë se çfarë kemi obliguar për ta në lidhje me gratë e tyre dhe me ato që ata zotërojnë si pre të luftës, që ti të mos kesh ndonjë ngushtim (duke menduar për ta). Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

وَبَشِّرِ الْمُؤْمِنِينَ بِأَنَّ لَهُمْ مِنَ اللَّهِ فَضْلًا كَبِيرًا ﴿٤٨﴾

وَلَا تُطِيعِ الْكٰفِرِينَ وَالْمُنٰفِقِينَ وَدَعْ اٰذَنَهُمْ وَتَوَكَّلْ عَلٰى اللّٰهِ ۗ وَكٰفٰى بِاللّٰهِ وَكٰيۡلًا ﴿٤٩﴾

يٰۤاَيُّهَا الَّذِيْنَ اٰمَنُوْا اِذَا نَكَحْتُمُ الْمُؤْمِنٰتِ ثُمَّ طَلَقْتُمُوهُنَّ مِنْ قَبْلِ اَنْ تَمْسُوهُنَّ فَمَا لَكُمْ عَلَيْهِنَّ مِنْ عَدُوَّةٍ تَعْتَدُوْنَهَا ۚ فَمِعُوهُنَّ وَسَرَٰحُوهُنَّ سَرَاحًا جَمِيۡلًا ﴿٥٠﴾

يٰۤاَيُّهَا النَّبِيُّ اِنَّا اَحَلَّلْنَا لَكَ اَزْوَاجَكَ الَّتِيْ اَتَيْتَ اُجُوْرَهُنَّ وَمَا مَلَكَتْ يَمِيْنُكَ مِمَّا اَفَاءَ اللّٰهُ عَلَيْكَ وَبَدَتْ عَمِّكَ وَبَدَتْ عَمَّتِكَ وَبَدَتْ خَالِكَ وَبَدَتْ خَالَتِكَ الَّتِيْ هٰجَرْنَ مَعَكَ ۗ وَاِمْرَاةً مُّؤْمِنَةً اِنْ وَّهَبَتْ نَفْسَهَا لِلنَّبِيِّ اِنْ اَرَادَ النَّبِيُّ اَنْ يَّسْتَنْكِحَهَا ۗ خَالِصَةً لَّكَ مِنْ دُوْنِ الْمُؤْمِنِيْنَ ۗ قَدْ عَلِمْنَا مَا فَرَضْنَا عَلَيْهِمْ فِيْ اَزْوَاجِهِمْ وَمَا مَلَكَتْ اَيْمَانُهُمْ لِكَيْلَا يَكُوْنُ عَلَيْكَ حَرَجٌ ۗ وَكَانَ اللّٰهُ غَفُوْرًا رَّحِيْمًا ﴿٥١﴾

17. Këtë Allahu ia kishte lejuar Profetit<sup>savs</sup>, por Profeti<sup>savs</sup> nuk e përdori këtë leje. Dikush mund të pyesë për *Hazret Marija Kopten*<sup>ra</sup>, por përgjigja për këtë është që ajo erdhi në një formë tjetër, kurse ky ajet flet për gratë që merren si robëresha në luftë. *Hazret Marija Kopten*<sup>ra</sup> ia kishte dërguar Mukaukisi Profetit<sup>savs</sup> sipas traditave mbretërore të tij. Por edhe me të është e vërtetuar që i Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> kishte lidhur kurorën me *nikah*.

52. Prej atyre (grave) largoje cilëndo dhe mbaje pranë vetes cilëndo.<sup>18</sup> Dhe nuk ke gjynah nëse dëshiron ta rimarrësh ndonjë nga ato që i ke ndarë. Kjo është më e mirë që atyre t'u qetësohen sytë, që ato të mos brengosen dhe të gjitha ato të gëzohen me atë që ti u jep. Allahu e di atë që keni në zemrat tuaja. Allahu është i Gjithëdijshëm, i Përmbajtur.

53. Pas kësaj, nuk të lejohen më gra të tjera dhe as nuk të lejohet që këto (gra të tuat) t'i ndërrosh me gra të tjera, edhe sikur të të mahnitë bukuria e tyre, përjashtim bëjnë ato që i zotëron ti.<sup>19</sup> Allahu është Mbikëqyrës mbi çdo gjë.

54. O ju që besuat! Mos hyni në shtëpitë e Profetit, përveçse kur ju jepet ftesë për të ngrënë, por jo që të shkoni atje e të prisni përgatitjen e tij (pra, të ushqimit), por të hyni vetëm kur të thirreni dhe pasi të mbaroni së ngrëni, largohuni dhe mos bëni biseda duke qëndruar (atje). Kjo e shqetëson Profetin dhe ai ka turp (t'ju thotë) juve, kurse Allahu nuk ka turp nga e vërteta. Nëse u kërkoni atyre (pra, grave të Profetit) ndonjë gjë, kërkojuni duke qëndruar mbrapa perdes. Kjo është më e pastër për zemrat tuaja dhe për zemrat e

تُرْجَىٰ مَنْ نَشَاءُ مِنْهُنَّ وَتُؤَيَّٰ إِلَيْكَ مَنْ  
نَشَاءُ ۗ وَمَنِ ابْتَعَيْتَ مِمَّنْ عَزَلْتَ فَلَا  
جُنَاحَ عَلَيْكَ ۗ ذَلِكَ أَدْنَىٰ أَنْ تَقَرَّ أَعْيُنُهُنَّ  
وَلَا يَحْرَنَ وَيَرْضَيْنَ بِمَا آتَيْتَهُنَّ كُلَّهُنَّ ۗ  
وَاللَّهُ يَعْلَمُ مَا فِي قُلُوبِكُمْ ۗ وَكَانَ اللَّهُ  
عَلِيمًا حَلِيمًا ﴿٥٢﴾

لَا يَحِلُّ لَكَ النِّسَاءُ مِنْ بَعْدُ وَلَا أَنْ تَبَدَّلَ  
بِهِنَّ مِنْ أَزْوَاجٍ وَ لَوْ أَعْجَبَكَ حُسْنُهُنَّ  
إِلَّا مَا مَلَكَتْ يَمِينُكَ ۗ وَكَانَ اللَّهُ عَلَىٰ  
كُلِّ شَيْءٍ رَاقِبًا ﴿٥٣﴾

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَدْخُلُوا بُيُوتَ النَّبِيِّ  
إِلَّا أَنْ يُؤْذَنَ لَكُمْ إِلَىٰ طَعَامٍ غَيْرٍ نَظِيرِ  
إِنَّهُ ۗ وَلَكِنْ إِذَا دُعِيتُمْ فَادْخُلُوا فَإِذَا  
طَعِمْتُمْ فَانْتَشِرُوا وَلَا مُسْتَأْنِسِينَ لِحَدِيثٍ ۗ  
إِنَّ ذِكْرَكُمْ كَانَ يُؤْذَى النَّبِيِّ فَيَسْتَجِي مِنْكُمْ ۗ  
وَاللَّهُ لَا يَسْتَجِي مِنَ الْحَقِّ ۗ وَإِذَا سَأَلْتُمُوهُنَّ  
مَتَاعًا فَسْأَلُوهُنَّ مِنْ وَرَاءِ حِجَابٍ ۗ ذِكْرُكُمْ  
أَظْهَرَ لِقُلُوبِكُمْ وَقُلُوبِهِنَّ ۗ وَمَا كَانَ  
لَكُمْ أَنْ تُؤْذُوا رَسُولَ اللَّهِ وَلَا أَنْ تُنْكِحُوا

18. Edhe pas kësaj lejeje, Profeti<sup>savs</sup> nuk divorcoi asnjërën prej grave të tij. Ashtu siç u provua që në 33:29 që asnjëra nga gratë e Profetit nuk e pëlqeu botën materiale dhe që të gjitha i dhanë përparësi besimit mbi botën, në të njëjtën mënyrë, edhe Profeti<sup>savs</sup> nuk divorcoi askënd prej tyre, pavarësisht se Zoti e kishte lejuar një gjë të tillë. Me një fjalë, edhe vendimi i Profetit<sup>savs</sup> ishte që gratë e tij ishin shembullore në besim dhe në virtyte.

19. Edhe për këtë e thamë më sipër (33:51) se kjo ishte një leje që Profeti<sup>savs</sup> nuk e ka përdorur.

tyre. Nuk ju lejohet të shqetësoni të Dërguarin e Allahut dhe as nuk ju lejohet që pas kësaj të martoheni me ndonjë nga gratë e tij. Kjo pa dyshim është e rëndë tek Allahu.

55. Nëse shfaqni diçka ose e fshihni, (dijeni) se Allahu është i Gjithëdijshëm për çdo gjë.

56. Nuk ka gjynah për to (pra, për gratë e Profetit) të dalin para baballarëve të tyre, bijve të tyre, vëllezërve të tyre, bijve të vëllezërve të tyre, motrave të tyre, grave të tyre (pra, para grave të tjera besimtare) dhe para atyre që ato i zotërojnë. (O gratë e Profetit!) Kini druajtje ndaj Allahut! Sigurisht, Allahu është Dëshmitar mbi çdo gjë.

57. Pa dyshim, Allahu dhe engjëjt e Tij bekojnë Profetin. O ju që besuat! Edhe ju lutuni për të dhe dërgojini salam sa më shumë.<sup>20</sup>

58. Njëmend, ata që lëndojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij, Allahu i ka mallkuar në këtë botë dhe (në) *ahiret* dhe ka përgatitur për ta ndëshkim poshtërues.

أَزْوَاجَهُ مِنْ بَعْدِهِ أَبَدًا ۗ إِنَّ ذِكْرَكُمْ كَانَ عِنْدَ  
اللَّهِ عَظِيمًا ﴿٥٥﴾

إِنْ تَبَدُّوا شَيْئًا أَوْ تَخْفَوْهُ فَإِنَّ اللَّهَ كَانَ  
بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمًا ﴿٥٦﴾

لَا جُنَاحَ عَلَيْهِنَّ فِي آبَائِهِنَّ وَلَا أَبْنَائِهِنَّ  
وَلَا إِخْوَانِهِنَّ وَلَا أَبْنَاءَ إِخْوَانِهِنَّ وَلَا نِسَائِهِنَّ وَلَا مَا مَلَكَتْ  
أَيْمَانُهُنَّ ۗ وَالتَّقِينِ اللَّهُ ۗ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلَى  
كُلِّ شَيْءٍ شَهِيدًا ﴿٥٧﴾

إِنَّ اللَّهَ وَمَلَائِكَتَهُ يُصَلُّونَ عَلَى النَّبِيِّ ۗ  
يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا صَلُّوا عَلَيْهِ وَسَلِّمُوا  
تَسْلِيمًا ﴿٥٨﴾

إِنَّ الَّذِينَ يُؤْذُونَ اللَّهَ وَرَسُولَهُ لَعَنَهُمُ  
اللَّهُ فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ وَأَعَدَّ لَهُمْ عَذَابًا  
مُهِينًا ﴿٥٩﴾

20. Ky ajet tregon se veprat e të Dërguarit të Allahut<sup>savs</sup> ishin të tilla që Allahu i Madhërishtëm nuk zgjodhi fjalë për t'i përkufizuar ose për t'i përshkruar ato. Fjalët edhe mund të gjendeshin, por Ai nuk i përdori. Pra, përshkrimi i veprave të tij nuk përmbledhet. Ajet si ky nuk gjendet për ndonjë profet tjetër. Shpirti i të Dërguarit të Allahut<sup>savs</sup> kishte sinqeritet dhe besnikëri të tillë dhe veprat e tij ishin kaq të pëlqyera tek Allahu, sa që Ai porositi njerëzit përgjithmonë që të luten për Profetin<sup>savs</sup> e t'i dërgojnë salam në shenjë mirënjohjeje.

59. Dhe ata që lëndojnë besimtarët dhe besimtare të për diçka që ata nuk e kanë bërë, ngarkojnë veten me barrën e një shpifjeje dhe të një mëkati të hapur.

وَالَّذِينَ يُؤْذُونَ الْمُؤْمِنِينَ وَالْمُؤْمِنَاتِ  
بِغَيْرِ مَا اكْتَسَبُوا فَقَدْ احْتَمَلُوا بُهْتَانًا وَإِثْمًا  
كَبِيرًا ﴿٥٩﴾

60. O Profet! Thuaju bashkëshorteve të tua, bijave të tua dhe grave të besimtarëve që ato të hedhin sipër vetes mbulesat e tyre. Kjo është më e përshtatshme që ato të njihen dhe që të tjerët të mos i shqetësojnë. Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.<sup>21</sup>

يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ قُلْ لَلرَّوَادِعِ وَبَنَاتِ  
وَالْمُؤْمِنِينَ يُدْنِينَ عَلَيْهِنَّ مِنْ جَلَابِيبِهِنَّ  
ذَلِكَ أَدْنَىٰ أَنْ يُعْرَفْنَ فَلَا يُؤْذَيْنَ وَكَانَ  
اللَّهُ غَفُورًا رَحِيمًا ﴿٦٠﴾

61. Hipokritët dhe ata të cilët kanë “sëmundje” në zemër si dhe ata që përhapin shpifjet në Medinë, nëse nuk tërhiqen, Ne patjetër do të të ngarkojmë ty kundër tyre. Më pas, ata nuk do të jenë dot fqinjë me ty, përveçse (për) shumë pak (kohë).

لَئِنْ لَّمْ يَنْتَهُ الْمُنَافِقُونَ وَالَّذِينَ فِي  
قُلُوبِهِمْ مَرَضٌ وَ الْمُرْجِفُونَ فِي الْمَدِينَةِ  
لَنُغْرِبَنَّكَ بِهِمْ ثُمَّ لَا يُجَاوِرُونَكَ فِيهَا  
إِلَّا قَلِيلًا ﴿٦١﴾

62. Janë të mallkuar; kudo që të gjenden, të kapen dhe të vriten keqas.

مَلْعُونِينَ أَيْنَمَا ثَقِفُوا أَخَذُوا وَقَتَلُوا  
تَقْتِيلًا ﴿٦٢﴾

63. (Kjo) ishte praktika e Allahut në lidhje me ata që kanë kaluar më parë. Dhe në praktikën e Allahut ti kurrë nuk do të gjesh ndonjë ndryshim.

سُنَّةَ اللَّهِ فِي الَّذِينَ خَلَوْا مِنْ قَبْلُ ۚ وَكَانَ  
تَجَدُّ لِسُنَّةِ اللَّهِ تَبْدِيلًا ﴿٦٣﴾

64. Njerëzit të pyesin rreth Orës. Thuaj: Dija rreth saj është vetëm tek Allahu. Dhe çka mund të të bindë ty se ndoshta Ora mund të jetë afër!

يَسْأَلُكَ النَّاسُ عَنِ السَّاعَةِ ۗ قُلْ إِنَّمَا عِلْمُهَا  
عِنْدَ اللَّهِ ۗ وَمَا يُدْرِيكَ لَعَلَّ السَّاعَةَ تَكُونُ  
قَرِيبًا ﴿٦٤﴾

21. Fjala *xhelabib* është shumësi i fjalës *xhilbab*, që do të thotë mbulesë e sipërme, e ngjashme me pallton, që mbulon gjithë trupin. Ajeti flet për mënyrën dhe arsyen e hixhabit. Lexoni edhe 24:31-32.

65. Pa dyshim, Allahu i ka mallkuar mohuesit dhe ka përgatitur për ta një zjarr flakërues.

إِنَّ اللَّهَ لَعَنَ الْكُفْرَيْنَ وَأَعَدَّ لَهُمْ سَعِيرًا ۝

66. Në të do të jetojnë ata për një kohë të gjatë. Nuk do të gjejnë (atje) as kujdestar e as ndihmës.

خُلِدِينَ فِيهَا أَبَدًا ۚ لَا يَجِدُونَ وَلِيًّا وَلَا نَصِيرًا ۝

67. Ditën kur do të hidhen për fytyrash në zjarr, do të thonë: “Ah sikur t’i bindeshim Allahut e t’i bindeshim të Dërguarit!”

يَوْمَ تَقَلَّبُ وُجُوهُهُمْ فِي النَّارِ يَقُولُونَ  
لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَآطَعْنَا الرَّسُولَ ۝

68. Dhe do të thonë: “O Zoti ynë! Ne ndoqëm prijësit dhe të mëdhenjtë tanë. Ata na kanë bërë të devijonim rrugën.

وَقَالُوا رَبَّنَا إِنَّا أَطَعْنَا سَادَتَنَا وَكُبَرَاءَنَا  
فَأَصَلُّونَا السَّبِيلَا ۝

69. O Zoti ynë! Atyre jepu ndëshkimin dyfish, mallkoji ata me ndonjë mallkim të madh.”

رَبَّنَا آتِهِمْ ضِعْفَيْنِ مِنَ الْعَذَابِ وَالْعَنَهُمْ  
عَجَّ لَعْنَا كَبِيرًا ۝

70. O ju që besuat! Mos u bëni si ata që lënduan Musain. Atëherë Allahu e liroi atë nga ajo që ata thanë. Dhe ai ishte i nderuar tek Allahu.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَكُونُوا كَالَّذِينَ آذَوْا  
مُوسَىٰ فَبَرَّاهُ اللَّهُ مِمَّا قَالُوا وَكَانَ عِنْدَ اللَّهِ  
وَجِيهًا ۝

71. O ju që besuat! Kini druajtje ndaj Allahut dhe thoni fjalë të drejta.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَقُولُوا قَوْلًا  
سَدِيدًا ۝

72. Ai do t’ju përmirësojë veprat dhe do t’ju falë gjynahet. Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, ka arritur një sukses madhështor.

يُصْلِحْ لَكُمْ أَعْمَالَكُمْ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ ۝  
وَمَنْ يُطِيعِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ فَقَدْ فَازَ فَوْزًا  
عَظِيمًا ۝

73. Pa dyshim, Ne paraqitëm përgjegjësinë përpara qiejve, tokës dhe maleve, por ato refuzuan ta

إِنَّا عَرَصْنَا الْأَمَانَةَ عَلَى السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ  
وَالْجِبَالِ فَأَبَيْنَ أَنْ يَحْمِلْنَهَا وَأَشْفَقْنَ



mbartnin dhe u frikësuan prej saj; dhe atë e mbarti njeriu; sigurisht, ai ishte tepër i padrejtë (ndaj vetes dhe) shumë i paditur (ndaj pasojave të kësaj përgjegjësie).<sup>22</sup>

74. Që Allahu të ndëshkojë hipokritët e hipokritet, idhujtarët e idhujtare, dhe t'u pranojë pendesën me mëshirë besimtarëve dhe besimtareve. Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

مِنْهَا وَحَمَلَهَا الْإِنْسَانُ إِنَّهُ كَانَ ظَلُومًا  
جَهُولًا ﴿٧٤﴾

لِيُعَذِّبَ اللَّهُ الْمُنَافِقِينَ وَالْمُنَافِقَاتِ  
وَالْمُشْرِكِينَ وَالْمُشْرِكَاتِ وَيَتُوبَ اللَّهُ عَلَى  
الْمُؤْمِنِينَ وَالْمُؤْمِنَاتِ وَكَانَ اللَّهُ عَفُورًا  
رَحِيمًا ﴿٧٥﴾

22. Fjala *njeriu* në këtë ajet i referohet Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, dhe kështu, kjo tregon një epërsi të tij ndaj të gjithë Profetëve të tjerë, sepse *amanetin* (përgjegjësinë) që mori ai prej Zotit, asnjë profet i mëparshëm nuk mund ta merrte dot. Pra, këtu fjala amanet i referohet Kuranit të Shenjtë. Disa komentues i interpretojnë në mënyrë të gabuar fjalët e fundit të këtij ajeti (*i padrejtë dhe i paditur*). Cilësia *i padrejtë (dhalum)* nuk është në raport me të tjerët por me vetveten dhe që do të thotë se u tregua shumë vetëmohues në marrjen e këtij *amaneti*. Kurse cilësia e të qenit *i paditur (xhehul)* nuk do të thotë i paditur për nga dija, por që nuk i mori parasysh pasojat dhe vështirësitë që do t'i vinin për shkak të kësaj përgjegjësie. Shikoni jetën e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, të gjitha vështirësitë e jetës atij i erdhën vetëm pasi deklaroi të ishte i Dërguari i Zotit.

## Surja 34 – Sebe

Surja Sebe është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka pesëdhjetë e pesë ajete.

Surja fillon me pohimin se e gjithë lavdia është e Allahut, që është Sunduesi i qiejve dhe i tokës; edhe kjo botë Atij i këndon lavde, edhe jeta pas kësaj bote Atij do t'i këndojë lavde. Kjo tregon se shërbëtorët e vërtetë të Profetit Muhammed<sup>savs</sup> do ta mbushin tokën dhe qiellin me lavdërimin e Allahut.

Pas kësaj, duke folur për malet, shpjegon se malet nënkuptojnë edhe malësorë, që janë njerëz të fuqishëm fizikisht, siç e thotë edhe në lidhje me *Hazret Davudin<sup>as</sup>*, pra, atij iu nënshtruan jo malet fizike, por popujt malësorë. Kjo në një aspekt shpjegon edhe simbolin e maleve që u përmend edhe në një prej ajeteve të fundit të sures paraardhëse.

Më pas tregon se xhindët që Allahu i nënshtroi për *Hazret Davudin<sup>as</sup>*, dhe që bënin punë shumë të rënda, nuk ishin diçka tjetër por njerëz. Këta xhindë nuk ishin krijesat që janë prej zjarri, pasi ata ishin zhytës profesionistë dhe uji do të ishte tërësisht kundër trupit të tyre, por ishin ata xhindë, për të cilët diku tjetër në Kuranin e Shenjtë thuhet se zhyteshin në det për të nxjerrë perla e margaritarë. Së dyti, kjo sure gjithashtu tregon se këta xhindë ishin të lidhur me zinxhirë, ndërkohë që krijesa prej zjarri nuk mund të lidhen në këtë formë. Të gjitha këto bekime, thotë Zoti në këtë sure, e obligonin familjen e Davudit që të ishin mirënjohës dhe i pari i kësaj familjeje, si biologjikisht ashtu edhe shpirtërisht, ishte *Hazret Sulejmani<sup>as</sup>*, i cili diti ta përmbushte edhe detyrën e falënderimit. Por, kur *Hazret Sulejmani<sup>as</sup>* mësoi se djali i tij që do ta trashëgonte fronin pas tij, ishte tërësisht materialist, pra, thotë se ka një trup që nuk ka jetë shpirtërore, atëherë *Hazret Sulejmani<sup>as</sup>* u lut – O Zot! Gjatë kohës së djalit tim, asgjësoje këtë mbretëri, pasi unë nuk kam lidhje me mbretërinë tokësore! Pikërisht kështu ndodhi. Pas *Hazret Sulejmanit<sup>as</sup>*, kur djali i tij erdhi në pushtet, po këta popuj malësorë [që u quajtën xhindë] me kalimin e kohës e kuptuan që mbreti i tyre ishte i paaftë dhe u rebeluan, dhe kështu mbretëria madhështore që kishte ngritur *Hazret Sulejmani<sup>as</sup>*, ra.

Kur mbretëritë e fuqishme shkatërrohen, familjet mbretërore, në vend që të kenë dashuri me njëri-tjetrin dhe në vend që të luten për bashkimin, shtojnë urrejtje edhe më shumë për njëri-tjetrin dhe urojnë largimin dhe ndarjen nga njëri-tjetri. Atëherë ndëshkimi i Allahut i shtyp kaq keq, saqë ata bëhen histori e së kaluarës. Edhe vendbanimet e tyre i ngjajnë një shkretëtire që kanë tek-tuk vetëm disa pemë me gjemba, ndërkohë ishin pikërisht këto vendbanime, të cilat dikur ishin të bekuara me kopshte, pemishte dhe ara të shumta.

Edhe një herë përsëritet mësimi i durimit që i ishte dhënë Profetit Muhammed<sup>savs</sup> në një prej ajeteve të fundit të sures së mëparshme, ku i thuhet – Ti vazhdo të durosh me çdo kusht. Gjithashtu, kjo sure e forcon Profetin duke i dhënë lajm të mirë – Mbretëritë e fuqishme të së kaluarës janë mbretëri të vogla në krahasim me

mbretërinë e fuqishme shpirtërore që Allahu i Madhërishëm do të të dhurojë ty.

Pas kësaj, kjo sure u bën thirrje kundërshtarëve që edhe ata t'i kërkojnë Allahut të Madhërishëm vendimin me anë të lutjes në atë mënyrë që, nga një ose nga dy veta t'i drejtohen Allahut e t'i luten Atij, dhe më pas do të kuptojnë se ky Mbret i dijes dhe i urtësisë (Profeti<sup>savs</sup>), të cilit iu shpall Kurani Urtiplotë, kurrsesi nuk është i çmendur.

Në vijim Zoti thotë – Mendo pak gjendjen e tyre, kur ata do të jenë në një ankth që nuk do t'u shqepet, atëherë Zoti do t'i zërë në një vend të afërt. Vendi i afërt është damari i qafës, dhe ajeti nënkupton që vetë brenda qenieve të tyre do të burojnë një ndëshkim tejet i rëndë. Dhe ajeti vijues flet për një vend të largët, gjë që tregon se njerëzit e tillë vetë e mbyllin derën e pendesës. Pra, përderisa ata nuk patën mundësi të pendoheshin duke parë ngjarjet vetë në jetën e tyre, si mund të pendohen nga frika e ndëshkimit të Allahut, gjë që atyre u duket shumë larg. Për mohuesit e tillë, Zoti i Madhërishëm krijon mes tyre dhe mes dëshirave të tyre një pengesë të pakapërcyeshme, siç Ai ka bërë edhe me mohuesit e mëparshëm, por fatkeqësisht, ata vijnë në të jetojnë me dyshime.

1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Lavdia është e Allahut, të cilit i takon gjithçka që është në qiej dhe gjithçka që është në tokë dhe e Atij është lavdia (edhe) në *ahiret*. Ai është i Urti, i Gjithinformuari.

الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي لَهُ مَا فِي السَّمَوَاتِ  
وَمَا فِي الْأَرْضِ وَلَهُ الْحَمْدُ فِي الْأَخِرَةِ ٥  
وَهُوَ الْحَكِيمُ الْخَبِيرُ ①

3. Ai di atë që hyn në tokë dhe atë që del prej saj; si dhe atë që zbret prej qiellit dhe atë që ngjitet në të. Ai është Mëshirëbërësi, Falësi.

يَعْلَمُ مَا يَلِجُ فِي الْأَرْضِ وَمَا يَخْرُجُ مِنْهَا  
وَمَا يَنْزِلُ مِنَ السَّمَاءِ وَمَا يَعْرُجُ فِيهَا ٦  
وَهُوَ الرَّحِيمُ الْغَفُورُ ①

4. Ata që mohuan thonë: “Nuk do të vijë Ora mbi ne”. Thuaj: Pse jo, për Zotin tim që është i Dijshmi i së padukshmes, ajo do t’ju vijë patjetër! Atij nuk i fshihet as edhe një grimcë, as në qiej e as në tokë, as ndonjë gjë më e vogël se ajo dhe as më e madhe, madje është (e shënuar) në një Libër të qartë.

وَقَالَ الَّذِينَ كَفَرُوا لَا تَأْتِينَا السَّاعَةُ ٧  
قُلْ بَلَىٰ وَرَبِّي لَتَأْتِيَنَّكُمْ ٨ لَعَلَّ الْعَيْبَةَ  
لَا يَعْرُبُ عَنْهُ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ فِي السَّمَوَاتِ  
وَلَا فِي الْأَرْضِ وَلَا أَصْغَرَ مِنْ ذَلِكَ  
وَلَا أَكْبَرَ إِلَّا فِي كِتَابٍ مُّبِينٍ ①

5. Që Ai t’i shpërblejë ata që besuan dhe bënë të mira. Pikërisht këta do të kenë falje e dhuratë të nderuar.

لَيَجْزِيَنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ  
أُولَٰئِكَ لَهُمْ مَغْفِرَةٌ وَرِزْقٌ كَرِيمٌ ①

6. Kurse ata që përpiqen të (Na) mundin në lidhje me shenjat Tona, do të kenë ndëshkim të llahtarshëm (e) të dhimbshëm.

وَالَّذِينَ سَعَوْا فِي آيَاتِنَا مُعْجِزِينَ أُولَٰئِكَ  
لَهُمْ عَذَابٌ مِّن رَّجْحِ أَلِيمٍ ①

7. Atyre që u është dhënë dija, do të shohin se pikërisht ajo që të është zbritur ty prej Zotit tënd është e

وَيَرَى الَّذِينَ أُوتُوا الْعِلْمَ الَّذِي أُنزِلَ  
إِلَيْكَ مِنْ رَبِّكَ هُوَ الْحَقُّ وَيَهْدِي إِلَى

vërteta dhe se ajo udhëzon drejt rrugës së Triumfuesit, të Lavdishmit.

8. Ata që mohuan thonë: “A t’ju tregojmë një njeri, i cili ju njofton se kur të grimcoheni tërësisht, do të dilni në një krijim të ri?”

9. Ka trilluar gënjeshtër mbi Allahun, apo është bërë i çmendur?” Jo! E vërteta është që ata që nuk besojnë *ahiretin*, janë në ndëshkim dhe në devijim të thellë.

10. Ata, a nuk kanë parë (shenjat që ndodhin) në qiell e (në) tokë, që janë para e pas tyre?! Po të duam Ne, mund t’i fundosim ata në tokë ose të hedhim mbi ta ndonjë copë të qiellit. Pa dyshim, në këtë ka shenjë për çdo rob të përlulur.

11. Sigurisht, i dhamë Davudit prej Vetes një bekim, (kur thamë) “O male! Përkuluni bashkë me të dhe, o zogj, edhe ju!” Zbutëm për të edhe hekurin.

12. (I thamë Davudit): “Përgatit parzmore (që janë) të plota (për gjithë trupin), bëji të vegjël rrathët (e tyre), dhe ju (të gjithë) bëni vepra të mira. Unë e shoh mirë atë që bëni.”<sup>1</sup>

صَرَاطِ الْعَزِيزِ الْحَمِيدِ ۝

وَقَالَ الَّذِينَ كَفَرُوا هَلْ نَدَّبَكُم عَلَى  
رَجُلٍ يَتَّبِعُكُم إِذَا مَرَّكُمْ كُلَّ مَمْرٍ ۙ  
إِنَّكُمْ لَفِي خَلْقٍ جَدِيدٍ ۝

أَفَتَرَى عَلَى اللَّهِ كَذِبًا أَمْ بِهِ حِجَّةٌ بَلِ  
الَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ بِالْآخِرَةِ فِي الْعَذَابِ  
وَالصَّلٰلِ الْبَعِيدِ ۝

أَفَلَمْ يَرَوْا إِلَىٰ مَا بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَمَا  
خَلْفَهُمْ مِّنَ السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ ۗ إِنَّ شَأْنَ  
نَحْسِفِ بِهِمُ الْأَرْضَ أَوْ نُسْقِطُ عَلَيْهِمْ  
كِسْفًا مِّنَ السَّمَاءِ ۗ إِنَّ فِي ذَٰلِكَ لَآيَةً  
لِّكُلِّ عَبْدٍ مُّنِيبٍ ۝

وَلَقَدْ آتَيْنَا دَاوُدَ مِنَّا فَضْلًا ۗ يُجِبَالٌ  
أَوْيِي مَعَهُ وَالطَّيْرَ ۗ وَآلَنَّا لَهُ الْحَدِيدَ ۝

إِنِ اعْمَلْ سَابِغَاتٍ وَقَدِّرْ فِي السَّرْدِ  
وَاعْمَلُوا صَالِحًا ۗ إِنِّي بِمَا تَعْمَلُونَ بَصِيرٌ ۝

1. Ajetet 11 – 12: Nënshtrimi i maleve do të thotë nënshtrimi i popujve malësorë që ishin shumë të fuqishëm fizikisht, të cilët i zotëronte *Hazret Davudi*<sup>as</sup>, dhe ata i kishin bërë atij disa punë shumë të vështira. Zogjtë mund të nënkuptojnë njerëz të dëlirë që ishin besimtarë të devotshëm të tij. Pra, ata u quajtën zogj në kuptimin shpirtëror. Një tjetër bekim që pati *Hazret Davudi*<sup>as</sup> ishte që Zoti i dha dijen si ta shkrinte hekurin dhe të bënte sende të dobishme prej tij. Pikërisht në kohën e tij filluan të përdroreshin parzmore me rrathë hekuri. Zoti



(Allahun)! Prej robërve të Mi, pak janë falënderues (të vërtetë).

عِبَادِيَ الشَّاكِرُونَ ﴿١١﴾

15. Kur ia dekretuam vdekjen (Sulejmanit), asgjë nuk e bëri të dallonte vdekjen e tij, përveç një krimbi tokësor (pra, djali i tij i padenjës), që po hante shkopin (domethënë mbretërinë) e tij. E kur u rrëzua (mbretëria e tij), xhindët (pra, popujt e fuqishëm malësorë) e kuptuan se po të dinin të padukshmen, nuk do të mbeteshin në ndëshkimin poshtërues.<sup>3</sup>

فَلَمَّا قَضَيْنَا عَلَيْهِ الْمَوْتَ مَا دَلَّهُمْ عَلَى مَوْتِهِ إِلَّا دَابَّةُ الْأَرْضِ تَأْكُلُ مِنْسَأَتَهُ ﴿١١﴾ فَلَمَّا خَرَّ تَبَيَّنَتِ الْجِنَّ أَنْ لَوْ كَانُوا يَعْلَمُونَ ﴿١٢﴾ انْعَبِ مَا لَيْسُوا فِي الْعَذَابِ الْمُهِينِ ﴿١٣﴾

16. Për (popullin) Saba kishte një shenjë në vendbanimet e tyre. Kishin dy kopshte, djathtas e majtas. (O populli i Sabasë!) Hani nga ushqimi që ju ka dhënë Zoti juaj dhe falënderojeni Atë. Një qytet i mbarë dhe një Zot shumë Falës.<sup>4</sup>

لَقَدْ كَانَ لِسَبَإٍ فِي مَسْكِنِهِمْ آيَةٌ ﴿١٤﴾ جَنَّتَيْنِ عَنْ يَمِينٍ وَ شِمَالٍ ۚ كُنُوزٌ مِنْ رِزْقِ رَبِّكُمْ وَاشْكُرُوا لَهُ ۗ بَلَدَةٌ طَيِّبَةٌ وَ رَبِّ غَفُورٌ ﴿١٥﴾

17. Por, ata u larguan (nga rruga e drejtë), atëherë Ne dërguam mbi ta përmbytjen e digës së thyer dhe

فَاعْرَضُوا فَاَرْسَلْنَا عَلَيْهِمْ سَيْلَ الْعَرِمِ وَبَدَّلْنَاهُمْ بِجَنَّتَيْهِمْ جَنَّتَيْنِ ذَوَاتِ أُكُلٍ

3. Pas përmendjes së këtyre bekimeve, Zoti i Madhërishëm porositi, jo vetëm Hazret Davudin<sup>as</sup>, por edhe gjithë familjen e tij që të jenë mirënjohës. Pra, për sa kohë që ata do të mbeteshin falënderues, do të vijonin t'i gëzonin këto bekime. Më vonë, në kohën e djalit të Hazret Sulejmanit<sup>as</sup>, Zoti i Madhërishëm ia hoqi këto dhunti, pasi ai ishte bosh nga ana shpirtërore dhe nuk kishte as aftësitë e sundimitarit. Pra, gjatë sundimit të djalit të tij, që quhej Rehoboam, u copëtua mbretëria madhështore e Hazret Sulejmanit<sup>as</sup> (1 i Mbretërve, kap. 12, 13, 14 & Jew. Enc. nën zërin "Rehoboam"). Nëse trashëgimtari i fronit është i denjë, vdekja e mbretit nuk ndihet aq shumë. Por trashëgimtari i padenjës i Hazret Sulejmanit<sup>as</sup> nuk kishte asnjë veti shpirtërore, madje ishte një krimb tokësor, andaj, e shkatërroi shkopin e sundimit.

4. Saba (ose Sheba) siç përmendet në 27:23, ishte një qytet i Jemenit, i quajtur gjithashtu Marib, ndodhej rreth tri ditë rrugë nga San'a. Për këtë qytet ka referenca në Dhiatën e Vjetër dhe në literaturën greke, romake dhe arabe, veçanërisht në mbishkrimet e Arabisë Jugore. Sabainët ishin një popull me shumë kulturë, të cilët Zoti i kishte begatuar me të gjitha komoditetet e jetesës. I gjithë vendi ishte pjellor, ku ata kishin ndërtuar kanale e diga të mëdha vaditëse. Më e famshmja prej tyre ishte Diga e Maribit, rrënojat e së cilës janë ende të dukshme.

të dyja kopshtet e tyre i kthyem në kopshte që kishin vetëm fruta të hidhura, shkurre dhe pak hide.

18. Kështu i dënuam ata për shkak se ishin bërë mosmirënjohës. Vallë, Ne a dënojmë (kështu) dikë tjetër përveç atyre që janë tepër mosmirënjohës?!

19. Dhe midis tyre dhe midis vendbanimeve që kishim bekuar, bëmë disa vendbanime të dalluara dhe mundësua shëtitje mes tyre. (Që ju të) shëtitni në to netëve e ditëve në gjendje paqeje.

20. Dhe (kur ata u bënë mosmirënjohës), thanë: “O Zoti ynë! Zgjate largësinë e udhëtimeve tona!” Ata i bënë keq vetvetes dhe Ne i bëmë rrëfime të së kaluarës dhe i copëtuam tërësisht. Pa dyshim, në këtë ka shenja për çdokënd që është shumë i duruar, shumë mirënjohës.

21. Dhe, sigurisht, djalli (pra, Iblisi) vërtetoi mendimin e tij kundër tyre. Atë e ndoqën ata, përveç një grupi prej besimtarëve.

22. Dhe ai nuk kishte asnjë pushtet mbi ta, por Ne donim të dallonim atë që beson *ahiretin*, nga ai që është në mëdyshje rreth tij. Zoti yt qëndron Mbrojtës mbi çdo gjë.

23. Thuaj: Thirrni ata që mendoni (për diçka) në vend të Allahut! Nuk zotërojnë as edhe një grimcë të vogël as në qiej e as në tokë dhe ata nuk

حَمَطٍ وَّ أَثْلِ وَّ شَيْءٍ مِّنْ سِدْرٍ قَلِيلٍ ﴿١٧﴾

ذَلِكَ جَزَائِهِمْ بِمَا كَفَرُوا ۗ وَهَلْ نُجْزِي  
إِلَّا الْكٰفِرِينَ ﴿١٨﴾

وَجَعَلْنَا بَيْنَهُمْ وَبَيْنَ الْقَرْيَاتِ الَّتِي بَرَكْنَا  
فِيهَا قُرًى ظَاهِرَةً ۗ وَ قَدَرْنَا فِيهَا السَّيْرَ ۗ  
سَيْرُوا فِيهَا لِيَالِي ۗ وَأَيَّامًا مِّنِينَ ﴿١٩﴾

فَقَالُوا رَبَّنَا بَعْدَ بَيْنِ أَسْفَارِنَا وَظَلَمُوا  
أَنْفُسَهُمْ فَجَعَلْنَاهُمْ أَحَادِيثَ وَمَزَقْنَاهُمْ كُلَّ  
مُمَزَّقٍ ۗ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِّكُلِّ صَبَّارٍ  
شٰكُورٍ ﴿٢٠﴾

وَلَقَدْ صَدَقَ عَلَيْهِمْ اِبْلِيسُ ظَنَّهُ فَاتَّبَعُوهُ  
إِلَّا قَرِيْقًا مِّنَ الْمُؤْمِنِينَ ﴿٢١﴾

وَمَا كَانَ لَهُ عَلَيْهِمْ مِّنْ سُلْطٰنٍ اِلَّا لِنَعْلَمَ  
مَنْ يُّؤْمِنُ بِالْآخِرَةِ مِمَّنْ هُوَ مِنْهَا فِي  
شَكٍّ ۗ وَرَبُّكَ عَلٰى كُلِّ شَيْءٍ حَفِيْظٌ ﴿٢٢﴾

قُلْ اِذْعُوا اِلَّذِيْنَ زَعَمْتُمْ مِّنْ دُوْنِ اللّٰهِ ۚ  
لَا يَمْلِكُوْنَ وِثْقَالَ ذَرَّةٍ فِى السَّمٰوٰتِ وَلَا  
فِى الْاَرْضِ وَمَا لَهُمْ فِيْهِمَا مِنْ شَرْكٍ ۗ وَمَا



kanë asnjë pjesë në to dhe asnjëri prej tyre nuk është ndihmës i Tij.

24. Asnjë ndërmjetësim nuk do të vlejë pranë Tij, përveçse nëse Vetë Ai i jep leje ndokujt. Kur atyre do t'ua largojmë ankthin nga zemrat, ata do t'i pyesin (ndërmjetësuesit e tyre): “Çfarë tha Zoti juaj?” Ata do të thonë: “Të vërtetën!” Ai është i Larti, i Madhi.

25. Pyet (mohuesit): Kush ju ushqen nga qiejt dhe toka? Thuaju (vetë): “Allahu! Ne ose ju me siguri jemi ose në udhë të drejtë, ose në devijim të qartë.”

26. Thuaj: “Nuk do të pyeteni për mëkatet tona dhe as ne nuk do të pyetemi për atë që bëni ju.”

27. Thuaj: Zoti ynë do të na tubojë e më pas do të vendosë me drejtësi mes nesh. Ai është Gjykatësi, i Gjithëdijshmi.

28. Thuaj: Tregomëni ata ortakë që ju keni lidhur me Të. Kurrë (nuk mund të ndodhë)! Madje, pikërisht Allahu është Mbizotëruesi, i Urti.

29. Dhe Ne të dërguam ty për të gjithë njerëzit si sihariqdhënës dhe alarmues, por shumica e njerëzve nuk e dinë.<sup>5</sup>

لَهُ مِنْهُمْ مَنْ ظَهَرَ ۝١٧

وَلَا تَنْفَعُ الشَّفَاعَةُ عِنْدَهُ إِلَّا لِمَنْ أَذِنَ لَهُ ۗ حَتَّىٰ إِذَا فُرِعَ عَنْ قُلُوبِهِمْ قَالُوا مَاذَا قَالَ رَبُّكُمْ ۗ قَالُوا الْحَقُّ ۖ وَهُوَ الْعَلِيُّ الْكَبِيرُ ۝١٨

قُلْ مَنْ يَرْزُقُكُمْ مِنَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ۗ قُلِ اللَّهُ ۗ وَإِنَّا أَوْ إِيَّاكُمْ لَعَلَىٰ هُدًى أَوْ فِي ضَلَالٍ مُّبِينٍ ۝١٩

قُلْ لَا نَسْأَلُونَ عَمَّا أَجْرَمْنَا وَلَا نُسْأَلُ عَمَّا تَعْمَلُونَ ۝٢٠

قُلْ يَجْمَعُ بَيْنَنَا رَبُّنَا ثُمَّ يَفْتَحُ بَيْنَنَا بِالْحَقِّ ۗ وَهُوَ الْفَاتِحُ الْعَلِيمُ ۝٢١

قُلْ أَرُونِي الَّذِينَ أَلْحَقْتُمْ بِهِ شُرَكَاءَ كَلَّا ۗ بَلْ هُوَ اللَّهُ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ۝٢٢

وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا كَافَّةً لِّلنَّاسِ بَشِيرًا وَنَذِيرًا ۗ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ ۝٢٣

5. Profeti Muhammed<sup>savs</sup> në mënyrë të përsëritur është shpallur në Kuran si i Dërguar për mbarë njerëzimin deri në fund të kohës. Lexoni edhe 21:108 dhe 25:2. Mesazhi i Islamit është një mesazh universal dhe Kurani i Shenjtë është Libri përfundimtar i shpallur, pas të cilit nuk

30. Atathonë: “Kur do të (plotësohet) ky premtim, nëse thoni të vërtetën?”

وَيَقُولُونَ مَتَى هَذَا الْوَعْدُ إِنْ كُنْتُمْ  
صَادِقِينَ ﴿٣٠﴾

31. Thuaj: “E keni një ditë të premtuar; së cilës nuk mund t'i ktheheni mbrapa për asnjë çast, e as nuk mund ta tejkaloni atë.”

قُلْ لَكُمْ مِيعَادٌ يَوْمٍ لَا تَسْتَأْخِرُونَ عَنْهُ  
الْعَمَلُ سَاعَةً وَلَا تَسْتَقْدِمُونَ ﴿٣١﴾

32. Ata që mohuan thanë: “Kurrë nuk do ta besojmë këtë Kuran dhe as ato (profeci) që ishin përpara tij!” Sikur të shihje kur keqbërësit do të qëndrojnë para Zotit të tyre. Disa prej tyre do të ndajnë fjalën me disa të tjerë. Ata që ishin të dobët do t'u thonë atyre që ishin mendjemëdhenj: “Sikur të mos ishit ju, ne me siguri do të ishim besimtarë!”

وَقَالَ الَّذِينَ كَفَرُوا لَنْ نُؤْمِنَ بِهَذَا  
الْقُرْآنِ وَلَا بِالَّذِي بَيْنَ يَدَيْهِ ۗ وَلَوْ تَرَى  
إِذِ الظَّالِمُونَ مَوْقُوفُونَ عِنْدَ رَبِّهِمْ ۗ يَرْجِعُ  
بَعْضُهُمْ إِلَىٰ بَعْضٍ الْقَوْلَ ۗ يَقُولُ الَّذِينَ  
اسْتَضَعَفُوا لِلَّذِينَ اسْتَكْبَرُوا لَوْ لَأَنْتُمْ  
لَكِنَّا مُؤْمِنِينَ ﴿٣٢﴾

33. Ata që ishin mendjemëdhenj do t'u thonë atyre që ishin të dobët: “Pse, ne ju kishim penguar nga udhëzimi, kur ai ju erdhi juve?! Jo, ju vetë ishit fajtorë.”

قَالَ الَّذِينَ اسْتَكْبَرُوا لِلَّذِينَ اسْتَضَعَفُوا  
أَنحُنُّ صَدَدْنَاكُمْ عَنِ الْهُدَىٰ بَعْدَ إِذْ  
جَاءَكُمْ بَلْ كُنْتُمْ مُجْرِمِينَ ﴿٣٣﴾

34. Dhe ata që ishin të dobët do t'u thonë atyre që qenë mendjemëdhenj: “Jo, në të vërtetë ky ishte mashtrimi i përnatshëm e i përditshëm (juaji), kur na porositnit që ta mohonim Allahun dhe Atij t'i bënim ortakë!” Ata do ta fshehin turpin e tyre, kur të shohin ndëshkimin. Ne do t'u vëmë pranga nëpër qafë atyre që mohuan. A do të dënohen vallë ata për ndonjë gjë tjetër, përveç asaj që kanë bërë?!

وَقَالَ الَّذِينَ اسْتَضَعَفُوا لِلَّذِينَ اسْتَكْبَرُوا  
بَلْ مَكْرُ اللَّيْلِ وَالنَّهَارِ إِذْ تَأْمُرُونَنَا أَنْ نَكْفُرَ  
بِاللَّهِ وَنَجْعَلَ لَهُ أَنْدَادًا ۗ وَأَسْرُوا التَّدَامَةَ  
لَمَّا رَأَوُا الْعَذَابَ ۗ وَجَعَلْنَا الْأَغْلَالَ فِي أَعْنَاقِ  
الَّذِينَ كَفَرُوا ۗ هَلْ يُجْزَوْنَ إِلَّا مَا كَانُوا  
يَعْمَلُونَ ﴿٣٤﴾

35. Sa herë që kemi dërguar një alarmues në ndonjë fshat, pasanikët e tij thanë: “Ne e mohojmë fuqishëm mesazhin që ju keni sjellë!”

36. Dhe thanë: “Jemi të shumtë si në pasuri, ashtu edhe me fëmijë dhe ne nuk do të ndëshkohemi.”

37. Thuaj: Pa dyshim, Zoti im i shton të mira kujt të dojë dhe (edhe) ia pakëson, por shumica e njerëzve nuk dinë.

38. As pasuritë tuaja e as fëmijët tuaj nuk janë diçka që mund t’ju mundësojnë ndonjë pozitë pranë Nesh, përveç atyre që besuan dhe bënë të mira. Pikërisht këta do të kenë shpërblim të dyfishtë për shkak të asaj që bënë, dhe ata do të jetojnë në paqe në shtëpi të larta.

39. Kurse ata që përpiqen të (Na) mundin në lidhje me shenjat Tona, do të jenë të pranishëm në ndëshkim.

40. Thuaj: Zoti im, pa dyshim, i shton të mira kujt të dojë prej robërve të Tij dhe (edhe) ia pakëson. Çdo gjë që shpenzoni ju (në rrugën e Tij), Ai patjetër do ta zëvendësojë atë, dhe Ai është Dhënësi më i mirë.

41. Dhe ditën kur Ai do t’i tubojë të gjithë e më pas do t’i pyesë engjëjt: “A janë këta që ju adhuroni ju?”

42. Ata do të thonë: “I Shenjtë je Ti! Ti je Miku ynë e jo ata, madje

وَمَا أَرْسَلْنَا فِي قَرْيَةٍ مِّنْ نَّذِيرٍ إِلَّا قَالَ مُتْرَفُوهَا إِنَّا بِمَا أُرْسِلْتُمْ بِهِ كَافِرُونَ ﴿٣٥﴾

وَقَالُوا نَحْنُ أَكْثَرُ أَمْوَالًا وَ أَوْلَادًا وَ مَا نَحْنُ بِمُعَذَّبِينَ ﴿٣٦﴾

قُلْ إِنَّ رَبِّي يَبْسُطُ الرِّزْقَ لِمَنْ يَشَاءُ وَ يَقْدِرُ ۗ وَ لَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٣٧﴾

وَمَا أَمْوَالُكُمْ وَلَا أَوْلَادُكُمْ بِالَّتِي تُقَرَّبُكُمْ عِندَنَا زُلْفَىٰ إِلَّا مَنْ آمَنَ وَ عَمِلَ صَالِحًا ۗ فَأُولَٰئِكَ لَهُمْ جَزَاءُ الصَّحْفِ بِمَا عَمِلُوا وَ هُمْ فِي الْعُرْفَاتِ أُمُونَ ﴿٣٨﴾

وَ الَّذِينَ يَسْعَوْنَ فِي الْبَنَاءِ مُعْجِرِينَ أُولَٰئِكَ فِي الْعَذَابِ مُخْضَرُونَ ﴿٣٩﴾

قُلْ إِنَّ رَبِّي يَبْسُطُ الرِّزْقَ لِمَنْ يَشَاءُ مِنْ عِبَادِهِ وَ يَقْدِرُ لَهُ ۗ وَ مَا أَنْفَقْتُمْ مِنْ شَيْءٍ فَهُوَ يُخْلِفُهُ ۗ وَ هُوَ خَيْرُ الرَّازِقِينَ ﴿٤٠﴾

وَ يَوْمَ يَحْشُرُهُمْ جَمِيعًا ثُمَّ يَقُولُ لِلْمَلَائِكَةِ أَهَؤُلَاءِ إِيَّاكُمْ كَانُوا يَعْبُدُونَ ﴿٤١﴾

قَالُوا سُبْحٰنَكَ أَنْتَ وَ لِيْنَا مِنْ دُونِهِمْ بَلْ

ata adhuronin xhindët; (madje), shumica e tyre ishin besimtarë të këtyre (xhindëve).”<sup>6</sup>

43. Andaj, sot askush prej jush nuk ka fuqi t'i bëjë tjetrit as dobi e as dëm. Ne do t'u themi atyre që bënin keq: “Shijoni ndëshkimin e zjarrit, të cilin ju e quanit gënjeshtër!”

44. Dhe kur atyre u lexohen ajetet Tona të qarta, thonë: “Ç’është ky përveçse një njeri i thjeshtë, që dëshiron t’ju ndalojë nga ajo që adhuronin etërit tuaj?” Dhe thonë: “Ç’është kjo përveçse një gënjeshtër e trilluar?” Ata që e mohuan të vërtetën kur ajo u erdhi, thanë: “Kjo është vetëm një magji e hapur!”

45. Ne nuk u kemi dhënë libra që ata t'i lexonin, dhe as nuk u kemi dërguar përpara teje ndonjë alarmues.

46. (Kështu) kundërshtuan edhe ata që ishin para tyre dhe këta nuk kanë arritur as një të dhjetën e (fuqisë së) asaj që Ne u kishim dhënë atyre. Ata i quajtën gënjeshtarë të Dërguarit e Mi. Si qe atëherë ndëshkimi Im!

كَانُوا يَعْبُدُونَ الْجِنَّ أَكْثَرَهُمْ بِهِمْ  
مُؤْمِنُونَ ﴿٤٣﴾

فَأَيُّوْمَ لَا يَمْلِكُ بَعْضُكُمْ لِبَعْضٍ نَفْعًا  
وَلَا ضَرًّا ۗ وَنَقُولُ لِلَّذِينَ ظَلَمُوا ذُوقُوا  
عَذَابَ النَّارِ الَّتِي كُنْتُمْ بِهَا تُكَذِّبُونَ ﴿٤٤﴾

وَإِذَا تُتْلَىٰ عَلَيْهِمْ آيَاتُنَا بَيِّنَاتٍ قَالُوا مَا هَذَا  
إِلَّا رَجُلٌ يُرِيدُ أَنْ يَصُدَّكُمْ عَمَّا كَانُ  
يَعْبُدُونَ أَبَاؤَكُمْ ۗ وَقَالُوا مَا هَذَا إِلَّا آفَافٌ  
مُّفْتَرَىٰ ۗ وَقَالَ الَّذِينَ كَفَرُوا لِلْحَقِّ لَمَّا  
جَاءَهُمْ ۗ إِنَّ هَذَا إِلَّا سِحْرٌ مُّبِينٌ ﴿٤٥﴾

وَمَا آتَيْنَاهُمْ مِنْ كُتُبٍ يَدْرُسُونَهَا وَمَا  
أَرْسَلْنَا إِلَيْهِمْ قَبْلَكَ مِنْ نَذِيرٍ ﴿٤٦﴾

وَكَذَّبَ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ ۗ وَمَا بَلَّغُوا  
مِعْشَارَ مَا آتَيْنَاهُمْ فَكَذَّبُوا رُسُلِي ۗ  
فَكَيْفَ كَانَ نَكِيرِ ﴿٤٧﴾

6. Edhe këtu fjala “xhindë” aludon për pushtetarët dhe oligarkët që veprojnë fshehtas për të luajtur me fatin e pjesës dërrmuese të njerëzve. Po në këtë sure ata janë quajtur “mendjemëdhenj” (34:34). Në një sure të mëparshme u quajtën “të mëdhenjtë” (33:69). Përveç kësaj, ky ajet thotë: “shumica e njerëzve u besojnë këtyre xhindëve”. Ne shohim që shumica e njerëzve në botë veprojnë siç i diktojnë pushtetarët, dhe jo ndonjë krijesë e mbinatyrshme e quajtur xhind. Zoti pa dyshim është i Plotfuqishëm të krijojë edhe krijesa të mbinatyrshme dhe të çfarëdollojshme, por ajo që është e qartë nga ajetet e Kuranit, është se xhindët që ndikojnë te njeriu nuk janë krijesa të mbinatyrshme, por janë vetë njerëz, ose krijesa të tjera tokësore që ndikojnë fshehtas te njerëzit. Lexoni edhe 6:129.

47. Thuaj: Unë ju këshilloj vetëm një gjë: Ngrihuni për Allahun dyshe-dyshe dhe individualisht, më pas mendohuni. Shoku juaj nuk ka asnjë çmenduri. Në të vërtetë ai është vetëm alarmues për ju, përpara një ndëshkimi të rëndë.

48. Thuaj: Shpërblimi që unë ju kërkoj, në të vërtetë, është për ju. Shpërblimi im është vetëm tek Allahu. Ai është Dëshmitar mbi çdo gjë.

49. Thuaj: Zoti im godet (gënjeshtren) me të vërtetën. (Ai është) i Gjithëdijshmi i të padukshmeve.

50. Thuaj: Erdhi e vërteta, dhe gënjeshttra as nuk mund të fillojë (diçka) e as nuk mund ta përsërisë (atë).

51. Thuaj: Nëse unë devijoj, do të devijoj kundër (të mirës) sime dhe nëse udhëzohem, kjo do të ndodhë vetëm për shkak se Zoti im më dërgon shpallje. Pa dyshim, Ai është Gjithëdëgjues, i Afërt.

52. Sikur të shihje kur ata do të jenë në ankth, nuk do të kenë asnjë rrugëdalje, në një vend të afërt, ata do të kapen.

53. Dhe do të thonë: “Ne e besuam këtë!” E si mund të arrijnë ata (besimin) nga një vend i largët?!”

قُلْ إِنَّمَا أَعْظَمُكُمْ يَٰوَاحِدَةٍ ۚ أَنْ تَقُومُوا  
لِلَّهِ مَثَلِي ۚ وَفَرَادَىٰ ثُمَّ تَتَكَبَّرُونَ ۗ مَا  
بِصَاحِبِكُمْ مِّنْ جِنَّةٍ ۗ إِنْ هُوَ إِلَّا نَذِيرٌ  
لَّكُمْ بَيْنَ يَدَيْ عَذَابٍ شَدِيدٍ ﴿٤٧﴾

قُلْ مَا سَأَلْتُمْ مِّنْ أَجْرٍ فَهُوَ لَكُمْ ۗ إِنْ  
أَجْرِي إِلَّا عَلَى اللَّهِ ۚ وَهُوَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ  
شَهِيدٌ ﴿٤٨﴾

قُلْ إِنْ رَّبِّي يَقْضِفَ بِالْحَقِّ عَلامَ  
الْغُيُوبِ ﴿٤٩﴾

قُلْ جَاءَ الْحَقُّ وَمَا يُبَدِّئُ الْبَاطِلَ وَمَا  
يُعِيدُ ﴿٥٠﴾

قُلْ إِنْ صَلَّيْتُ فَإِنَّمَا أَضِلُّ عَلَىٰ نَفْسِي ۚ  
وَإِنْ اهْتَدَيْتُ فِيمَا يُوحَىٰ إِلَيَّ رَبِّي ۗ إِنَّهُ  
سَمِيعٌ قَرِيبٌ ﴿٥١﴾

وَلَوْ تَرَىٰ إِذْ فَرَغُوا فَلَا قُوَّةَ وَآخِذُوا  
مِّنْ مَّكَانٍ قَرِيبٍ ﴿٥٢﴾

وَ قَالُوا آمَنَّا بِهِ ۚ وَإِنَّهُمْ لَتَبَاؤُسٌ مِّنْ  
مَّكَانٍ بَعِيدٍ ﴿٥٣﴾

7. Pra, Zoti thotë – ata që janë larg Meje, si t'ua dëgjoj lutjen?! Me një fjalë, Zoti na mëson një të vërtetë shpirtërore me një ligj të përgjithshëm të natyrës. Jo sepse Zoti nuk mund të

54. Në të vërtetë ata e mohuan edhe më parë. Ata do të hamendësojnë rreth të padukshmes nga një vend i largët.

وَقَدْ كَفَرُوا بِهِ مِنْ قَبْلُ وَيَقْدِفُونَ  
بِالْغَيْبِ مِنْ مَّكَانٍ بَعِيدٍ ٥٤

55. Do të vihet një ndarje midis tyre dhe midis asaj që ata dëshirojnë, siç ndodhi me të ngjashmit e tyre më parë.<sup>8</sup> Pa dyshim, ata gjithmonë kanë qenë në një dyshim shqetësues.

وَجِيلَ بَيْنَهُمْ وَبَيْنَ مَا يَشْتَهُونَ كَمَا فُعِلَ  
بِأَشْيَاعِهِمْ مِنْ قَبْلُ إِنَّهُمْ كَانُوا فِي شَكٍّ  
مُتَرَيِّبٍ ٥٥

dëgjojë. Përkundrazi, Ai na di edhe dëshirat tona më të fshehta, madje edhe ato që ende nuk kanë lindur, por këtu ky ajet, na tërheq vëmendjen për të qenë më afër Zotit, sepse zërat nga larg nuk dëgjoen qartë. Në këtë mënyrë, ai që është në shkujdesje dhe që mbetet i përfshirë në mosbindje e në veprime të pamoralshme, i largohet Zotit aq shumë, saqë mes tij e Zotit largësia vetëm shtohet, rrjedhimisht vetë gjendja e tij ia pamundëson pranimin e lutjeve të tij.

8. Në jetën e kësaj bote, njeriu i keq ushqen një ferr dëshirash dhe epshesh brenda vetes dhe në momente humbjesh, e ndien afshin e këtij ferri. Kështu që, kur Zoti do ta largojë atë nga epshet e tij të vdekshme dhe ai do të pësojë dëshpërime të përhershëm, Zoti i Madhërishtëm atij do t'ia shfaqë këto dëshpërime në formën e një zjarri fizik. Siç e thotë në këtë ajet: mes tyre dhe mes gjërave që ata dëshironin, do të vihet një ndarje. Ky pikërisht do të jetë burimi i ndëshkimit. Shkurt, Zoti kurrë nuk i sjell vështirësi robit, përkundrazi, Ai ia vë përpara vetëm punët e këqija të tij.

## Surja 35 – Fatir

Surja Fatir është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka dyzet e gjashtë ajete.

Sikurse surja e mëparshme, edhe kjo sure fillon me El-Hamdu (Lavdia). Në suren e mëparshme lexuam që Sundimi i Zotit të Madhërisëm shtrihet mbi tërë qiejt dhe tokën dhe se i gjithë universi është i zënë në lavdërimin e Tij. Ndërsa kjo sure përmend lavdërimin e Allahut duke iu referuar momentit kur u krijuan për herë të parë qiejt dhe toka, sepse krijimi i tyre nuk ishte i paqëllim, madje tregon mëshirën e një Zoti të Gjithëmëshirshëm (*Rrahman*).

Ajeti nr. 2 flet për engjëjt që kanë nga dy, tre a katër krahë. Kjo aspak nuk do të thotë se ata të kenë krahë fizikë sikur krahët tanë apo të gjallesave të tjera tokësore. Në kontekstin e krijimit të qiejve e të tokës, katër krahë mund t'u referohen edhe katër valencave të atomit, falë të cilave ndodhin të gjitha mrekullitë kimike. Shkencëtarët që besojnë në Zot, na tërheqin vëmendjen se kur katër valencat e karbonit u bashkuan në një mënyrë të veçantë me disa elemente të tjera, formuan jetën me bazë karboni. Ky ajet i Kuranit gjithashtu tregon se ka engjëj që kanë krahë edhe më shumë, për të cilët ju ende nuk jeni në dijeni. Pra, ndikimi i këtyre engjëjve do të shkaktonte shndërrime të jashtëzakonshme kimike, të cilat njeriu i kohës së Profetit<sup>savs</sup> as nuk mund t'i imagjinonte dot.

Edhe një herë në këtë sure flitet rreth dy deteve, ku njëri ka ujë të njelmët dhe tjetri të ëmbël, por krijimtaria befasuese e Allahut është e tillë që gjallesat e të dyja deteve kanë mish të shijshëm. Si mund të ketë ndodhur që peshqit, të cilët gjatë gjithë kohës jetojnë në ujë të njelmët dhe ushqehen prej tij, të jenë të pastër nga ndikimet kimike të ujit të tillë?!

Pas kësaj, kjo sure sjell disa ajete (ajetet 17 e 18), të cilat paralajmërojnë njerëzimin duke thënë: Nëse nuk bëheni mirënjohës për bekimet e Allahut të Madhërisëm dhe këmbëngulni ta mohoni Atë, nëse do, Allahu mund t'ju asgjësojë nga toka dhe mund t'ju zëvendësojë me një krijesë tjetër, dhe kjo nuk është aspak kundër Madhësisë së Tij.

Edhe një herë Zoti tërheq vëmendjen e njeriut se çdo formë e jetës në tokë bekohet nga uji që zbret prej qiellit, dhe pas bashkimit të tyre dalin gjithfarë frutash, dhe të gjitha ato kanë ngjyra të ndryshme. Ndryshimi i ngjyrave të tyre tregon se ashtu siç i njëjti dhe nxjerr fruta të ndryshme me ngjyra të ndryshme, po kështu, njerëzit edhe pse vijnë nga i njëjti Adem, kanë ngjyra dhe gjuhë të ndryshme. Duhet thënë se edhe gjuhët kanë dalë nga një gjuhë e vetme e më pas u degëzuan, dhe tanimë ato kanë kaq shumë ndryshime me njëra-tjetrën, saqë nuk duket se kanë prejardhje të njëjtë, por ata të cilëve Allahu u ka dhënë njohuri shpirtërore, e kuptojnë këtë fakt.

Ka njerëz që nuk gjejnë ndonjë ortak ose diçka tjetër në tokë për ta barazuar a shoqëruar me Zotin e Madhërisëm, por ata çojnë hamendësimet e tyre nëpër qiej

për të gjetur ortakë të tillë, ndërkohë që ata nuk kanë aspak dije të saktë rreth qiejve. Më pas, kjo sure u tërheq vëmendjen njerëzve duke thënë se toka e qielli jo më kot qëndrojnë në orbitat e tyre, madje, nëse nuk do t'i mbante Dora e Fuqishme e caktimit të Allahut, të gjithë trupat qiellorë përnjëherë do t'i lëshonin orbitat e veta, duke dalë jashtë kontrollit përgjithmonë dhe duke shkaktuar apokalips në tokë e në qiell.





Ajetet:  
46

سُوْرَةُ فَاطِرٍ  
35. FATIR  
Mekase

Rukutë:  
5

1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Lavdia është e Allahut, Krijuesit të qiejve e të tokës, Bërësit të engjëjve si lajmëtarë, me nga dy, tre e katër krahë. Ai shton në krijim çfarë të dojë. Pa dyshim, Allahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë.<sup>1</sup>

الْحَمْدُ لِلَّهِ فَاطِرِ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ  
جَاعِلِ الْمَلَكِةِ رُسُلًا أُولَىٰ أَجْنِحَةٍ  
مَّثْنَىٰ وَثُلَّةٍ ۖ وَرُبْعٍ ۗ يُزِيدُ فِي الْخَلْقِ مَا  
يَشَاءُ ۗ إِنَّ اللَّهَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ①

3. Mëshirën që Allahu e hap për njerëzit, nuk ka kush ta ndalë. Dhe atë që Ai e ndal, pas kësaj nuk ka kush ta lëshojë. Ai është Mbizotëruesi, i Urti.

مَا يَفْتَحِ اللَّهُ لِلنَّاسِ مِنْ رَحْمَةٍ فَلَا  
مُمْسِكَ لَهَا ۗ وَمَا يُمْسِكُ ۗ فَلَا يُرْسِلُ لَهُ  
مِنْ بَعْدِهِ ۗ وَهُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ②

4. O njerëz! Kujtoni bekimin e Allahut mbi ju. A ka ndonjë krijues tjetër përveç Allahut, i cili ju furnizon nga qielli e toka?! Nuk ka të adhurueshëm tjetër përveç Atij. Atëherë ku po vërtiteni ju?!

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اذْكُرُوا نِعْمَتَ اللَّهِ عَلَيْكُمْ ۗ  
هَلْ مِنْ خَالِقٍ غَيْرِ اللَّهِ يَرْزُقُكُمْ مِّنَ  
السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ ۗ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ ۗ فَآلَىٰ  
تَوَفَّكُونَ ④

1. Sipas fjalorit, krahët janë një simbol i fuqive dhe i aftësive. Kështu që, ajeti tregon se engjëjt zotërojnë fuqi dhe cilësi në shkallë të ndryshme dhe në përputhje me rëndësinë e punës që i besohet secilit prej tyre. Disa pyesin – Pse Zoti ka nevojë për engjëjt, sikurse mbretërit e kësaj bote që kanë nevojë për parinë e tyre që e ndihmojnë? Zoti i Madhërishtëm nuk ka nevojë për asgjë, as për engjëjt, as për diellin, as për hënën, as për yjet. Por Ai kështu deshi krijimin e Tij, në mënyrë që fuqitë e Tij të njihen nëpërmjet mjeteve të ndryshme dhe nga kjo metodë, njeriu të shtojë urtësinë dhe dijen e vet. Po të mos ishte mediumi i mjeteve në mes, nuk do të kishim në botë as shkencën e astronomisë, as fizikën, as mjekësinë, as biologjinë e as ndonjë dije tjetër. Janë pikërisht mjetet që lindën dijen. Pra, urtësia absolute e Zotit deshi të krijonte mjete nga më të ndryshmet për rritjen dhe edukimin trupor të njeriut, dhe krijoi ndikues të llojllojshëm të botës lëndore, në mënyrë që ata të bëjnë ndikime në mënyra të ndryshme në trupin njerëzor. Dhe po Ai i Adhurueshmi i Vetëm, i cili edhe në punët e Tij ka njëshmërinë dhe harmoninë, deshi që edhe edukimin shpirtëror të njeriut ta bëjë në të njëjtën formë dhe me të njëjtin lloj sistemi. Ai kështu bëri, në mënyrë që të dyja sistemet, pra sistemi i botës lëndore dhe ai i botës së padukshme, ose sistemi fizik dhe sistemi shpirtëror, me njëtrajtshmërinë dhe harmoninë e tyre të dëshmojnë ekzistencën e Krijuesit të Vetëm dhe të provojnë se Ai është Organizatori që përdor vullnetin e Tij.

5. Nëse të quajnë gënjeshtar, edhe të Dërguarit para teje i kanë quajtur gënjeshtarë. Tek Allahu kthehen çështjet.

6. O njerëz! Premtimi i Allahut pa dyshim është i vërtetë, prandaj, nuk duhet t'ju mashtrojë jeta e kësaj bote, dhe mashtruesi i madh (pra, djalli) nuk duhet t'ju mashtrojë në lidhje me Allahun.

7. Djallin e keni armik, prandaj, trajtojeni atë si armik. Ai thërret grupin e tij vetëm që ata të bëhen banorë të zjarrit flakërues.

8. Ata që mohuan, do të kenë ndëshkim të fortë, kurse ata që besuan dhe bënë të mira, do të kenë falje dhe një shpërblim të madh.

9. Kush mund të jetë (më i mashtruar se) ai të cilit iu tregua e zbukuruar vepra e tij e keqe dhe ai filloi ta shohë të bukur atë?! Pa dyshim, Allahu e cilëson të devijuar kë të dojë dhe udhëzon kë të dojë. Ti nuk duhet ta lëshosh veten duke u brengosur për ta. Sigurisht, Allahu është i Gjithëdijshëm për atë që ata bëjnë.

10. Allahu është Ai që dërgon erërat; ato mbartin re. Më pas Ne i shtyjme drejt një qyteti të vdekur dhe përmes tyre i japim jetë tokës pas vdekjes së saj. Ja, kështu është ringjallja.

وَأَنْ يُكَذِّبُوكَ فَقَدْ كَذَّبَتْ رَسُولٌ مِّنْ قَبْلِكَ ۗ وَإِلَى اللَّهِ تُرْجَعُ الْأُمُورُ ۝

يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنَّ وَعْدَ اللَّهِ حَقٌّ فَلَا تَغُرَّنَّكُمُ الْحَيَاةُ الدُّنْيَا ۗ وَلَا يَغُرَّنَّكُمُ بِاللَّهِ الْغُرُورُ ۝

إِنَّ الشَّيْطَانَ لَكُمْ عَدُوٌّ فَاتَّخِذُوهُ عَدُوًّا ۗ إِنَّمَا يَدْعُوا حِزْبَهُ لِيَكُونُوا مِنْ أَصْحَابِ السَّعِيرِ ۝

الَّذِينَ كَفَرُوا لَهُمْ عَذَابٌ شَدِيدٌ ۗ وَالَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَهُمْ مَغْفِرَةٌ وَأَجْرٌ كَبِيرٌ ۝

أَفَمَنْ زُيِّنَ لَهُ سُوءُ عَمَلِهِ فَرَأَاهُ حَسَنًا ۗ فَإِنَّ اللَّهَ يُوْضِلُ مَنْ يَشَاءُ وَيَهْدِي مَنْ يَشَاءُ ۗ فَلَا تَذْهَبْ نَفْسُكَ عَلَيْهِمْ حَسْرَتٍ ۗ إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ بِمَا يَصْعَوْنَ ۝

وَاللَّهُ الَّذِي أَرْسَلَ الرِّيحَ فَتُبْرِئُ سَحَابًا فَأَسْقِنَهُ إِلَىٰ بَلَدٍ مَّيِّتٍ فَأَحْيَيْنَا بِهِ الْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا ۗ كَذَلِكَ النُّشُورُ ۝

11. Ai që kërkon nderin, i gjithë nderi është i Allahut. Tek Ai ngjitet fjala e pastër, të cilën e ngre vepra e mirë. Dhe ata që intrigojnë të këqija, do të kenë ndëshkim të fortë. Intriga e tyre do të shkatërrohet patjetër.<sup>2</sup>

12. Allahu ju krijoi prej dheu, më pas prej sperme, më pas ju bëri çifte. Asnjë femër nuk bëhet me barrë dhe as nuk e lind atë, përveçse sipas dijes së Allahut. Dhe asnjë të moshuari nuk i zgjatet jeta dhe as nuk i pakësohen vite nga mosha e tij, por (sipas asaj që) është (e shënuar) në një Libër. Pa dyshim, kjo për Allahun është e lehtë.

13. Nuk mund të jenë njësoj dy dete: ky shumë i ëmbël, i shijshëm për të pirë, dhe ky tjetri fort i njelmët. Dhe nga secili, ju hani mish të freskët dhe nxirni stoli që i mbani. Ti sheh anijet në të që lundrojnë duke çarë (ujin). (I gjithë ky sistem shërben) që ju të kërkon diçka nga bekimi i Tij dhe që të jeni mirënjohës.

14. Ai fut natën në ditë dhe fut ditën në natë; Ai nënshtroi diellin dhe hënën. Secili lundron deri në një afat të caktuar. Ky është Allahu, Zoti juaj; i Atij është sundimi. Dhe ata që ju i lusni në vend të Tij, nuk sundojnë as sa cipa e farës së hurmës.

مَنْ كَانَ يُرِيدُ الْعِزَّةَ فَلِلَّهِ الْعِزَّةُ جَمِيعًا  
إِلَيْهِ يَصْعَدُ الْكَلِمُ الطَّيِّبُ وَالْعَمَلُ  
الصَّالِحُ يَرْفَعُهُ وَالَّذِينَ يَمْكُرُونَ السَّيِّئَاتِ  
لَهُمْ عَذَابٌ شَدِيدٌ وَمَكْرُ أُولَئِكَ هُوَ  
يَبْوَرُ ⑩

وَاللَّهُ خَلَقَكُمْ مِنْ تُرَابٍ ثُمَّ مِنْ نُطْفَةٍ  
ثُمَّ جَعَلَكُمْ أَرْوَاجًا وَمَا تَحْمِلُ مِنْ أُنْثَى  
وَلَا تَضَعُ إِلَّا يَعْلَمُهُ وَمَا يَعْمُرُ مِنْ مَعْمَرٍ  
وَلَا يَنْقُصُ مِنْ عُمُرِهِ إِلَّا فِي كِتَابٍ إِنَّ ذَلِكَ  
عَلَى اللَّهِ يَسِيرٌ ⑪

وَمَا يَسْتَوِي الْبَحْرَانِ هَذَا عَذْبٌ فُرَاتٌ  
سَائِغٌ شَرَابُهُ وَهَذَا مِلْحٌ أُجَاجٌ وَمِنْ كُلِّ  
تَأْكُلُونَ لَحْمًا طَرِيًّا وَتَسْتَخْرِجُونَ حَلِيَّةً  
تَلْبَسُونَهَا وَتَرَى الْفُلْكَ فِيهِ مَوَازِرَ  
يَتَّبِعُوا مِنْ فَضْلِهِ وَلَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ ⑫

يُؤَيِّجُ الْآيِلَ فِي النَّهَارِ وَيُؤَيِّجُ النَّهَارَ فِي الْآيِلِ  
وَسَخَّرَ الشَّمْسَ وَالْقَمَرَ كُلٌّ يَجْرِي  
لِأَجَلٍ مُّسَمًّى ذَلِكُمُ اللَّهُ رَبُّكُمْ لَهُ  
الْمُلْكُ وَالَّذِينَ تَدْعُونَ مِنْ دُونِهِ مَا  
يَمْلِكُونَ مِنْ قِطْمِيرٍ ⑬

2. Disa njerëz mendojnë se do të kenë nderin nëse i kanë miq njerëzit e fuqishëm të kësaj bote, por Zoti i Madhërisëm u thotë besimtarëve se nderi i vërtetë vjen vetëm nga Ai dhe se kundërshtarët e Tij tentojnë t'i poshtërojnë besimtarët, por do të dështojnë.

15. Nëse i lusni, nuk do t'ju dëgjojnë lutjen. Edhe nëse e dëgjojnë, nuk do t'ju përgjigjen. Ditën e Kiametit do të mohojnë adhurimin tuaj që bënit ndaj tyre. Askush nuk mund të të njoftojë ty sikurse i Gjithinformuari.

16. O njerëz! Jeni ju që jeni nevojtarë të Allahut, kurse Allahu është i Pasuri, i Lavdishmi.

17. Nëse do Ai, mund t'ju largojë ju dhe të sjellë një krijim të ri.

18. Dhe kjo për Allahun nuk është fare e vështirë.

19. Asnjë mbartës nuk do të mbajë barrën e tjetrit. Kur një (shpirt) që është i ngarkuar, do të lusë (tjetrin) për (ta mbajtur) barrën e tij, qoftë të afërmin e vet, ai nuk do të mbajë dot asgjë prej saj. Ti mund t'i alarmosh vetëm ata që frikësohen nga Zoti i tyre (edhe) në fshehtësi dhe që falin namazin. Kushdo që pastrohet, pastrohet për shpirtin e vet. Tek Allahu është kthimi.

20. Nuk mund të jenë të barabartë i verbri dhe ai që sheh;

21. as errësirat dhe drita;

22. as hija dhe vapa.

23. Po kështu, nuk mund të barazohen të gjallët dhe të vdekurit. Pa dyshim, Allahu e bën të dëgjojë kë të dojë, dhe ti nuk mund t'i bësh të dëgjojnë ata që janë në varre.

إِنْ تَدْعُوهُمْ لَا يَسْمَعُوا دُعَاءَكُمْ ۖ وَلَوْ سَمِعُوا مَا اسْتَجَابُوا لَكُمْ ۗ وَيَوْمَ الْقِيَامَةِ يَكْفُرُونَ بِشِرْكِكُمْ ۗ وَلَا يُنَبِّئُكَ مِثْلُ خَيْرٍ ۚ

يَا أَيُّهَا النَّاسُ أَنْتُمُ الْفُقَرَاءُ إِلَى اللَّهِ ۗ وَاللَّهُ هُوَ الْغَنِيُّ الْحَمِيدُ ۝

إِنْ يَشَاءُ يُدْهِبْكُمْ وَيَأْتِ بِخَلْقٍ جَدِيدٍ ۝  
وَمَا ذَلِكَ عَلَى اللَّهِ بِعَزِيزٍ ۝

وَلَا تَزِرُ وَازِرَةٌ وِزْرَ أُخْرَى ۗ وَإِنْ تَدْعُ مُثْقَلَةٌ إِلَىٰ جِلْهَا لَا يَحْمِلُ مِنْهُ شَيْءٌ وَلَا تَكُنْ دَا قُرْبَىٰ ۗ إِنَّمَا تُنذِرُ الَّذِينَ يَخْشَوْنَ رَبَّهُم بِالْغَيْبِ وَأَقَامُوا الصَّلَاةَ ۗ وَمَنْ تَزَكَّىٰ فَإِنَّمَا يَتَزَكَّىٰ لِنَفْسِهِ ۗ وَإِلَى اللَّهِ الْمَصِيرُ ۝

وَمَا يَسْتَوِي الْأَعْمَىٰ وَالْبَصِيرُ ۝

وَلَا الظُّلُمَاتُ وَلَا النُّورُ ۝

وَلَا الظُّلُّ وَلَا الْحَرُورُ ۝

وَمَا يَسْتَوِي الْأَحْيَاءُ وَلَا الْأَمْوَاتُ ۗ إِنَّ اللَّهَ يُسْمِعُ مَنْ يَشَاءُ ۗ وَمَا أَنْتَ بِمُسْمِعٍ مَنْ فِي الْقُبُورِ ۝

24. Ti je vetëm një alarmues.

إِنَّ أَنْتَ إِلَّا نَذِيرٌ ﴿١٤﴾

25. Ne të dërguam me të vërtetën si sihariqdhënës dhe alarmues. Dhe në çdo popull ka ardhur ndonjë alarmues.<sup>3</sup>

إِنَّا أَرْسَلْنَاكَ بِالْحَقِّ بَشِيرًا وَنَذِيرًا ۗ وَإِنْ مِنْ أُمَّةٍ إِلَّا خَلَا فِيهَا نَذِيرٌ ﴿١٥﴾

26. Nëse ata të quajnë gënjeshtar, edhe ata që ishin para tyre quajtën gënjeshtarë (profetët e tyre). (Edhe) atyre u kishin ardhur profetët e tyre me shenjat e qarta, me skriptet dhe me Librin e ndritur.

وَإِنْ يُكَذِّبُوكَ فَقَدْ كَذَّبَ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ ۖ جَاءَتْهُمْ رُسُلُهُمْ بِالْبَيِّنَاتِ ۖ وَالزُّبُرِ ۖ وَالْكِتَابِ الْمُنِيرِ ﴿١٦﴾

27. Pastaj Unë i kapa ata që mohuan. Eh si qe kapja Ime!

ثُمَّ أَخَذْتُ الَّذِينَ كَفَرُوا فَكَيْفَ كَانَ نَكِيرِ ﴿١٧﴾

28. A nuk e ke parë që Allahu zbret ujë prej qiellit?! Më pas Ne nxjerrim prej tij gjithfarë frutash të ngjyrave të ndryshme; dhe ka male që kanë vija të bardha, të kuqe dhe të ngjyrave të ndryshme dhe (edhe) të zeza të errëta.

أَلَمْ تَرَ أَنَّ اللَّهَ أَنْزَلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً ۖ فَأَخْرَجْنَا بِهِ ثَمَرَاتٍ مُخْتَلِفًا أَلْوَانُهَا ۗ وَمِنَ الْجِبَالِ جُدَدٌ بَيضٌ وَحُمْرٌ مُخْتَلِفٌ أَلْوَانُهَا ۚ وَغَرَابِيبُ سُودٌ ﴿١٨﴾

29. Po kështu, edhe nga njerëzit, kafshët dhe bagëtitë janë të ngjyrave të ndryshme. Pa dyshim, prej robërve të Tij vetëm ata i frikësohen Allahut

وَمِنَ النَّاسِ وَالْدَّوَابِّ ۗ وَالْأَنْعَامِ مُخْتَلِفٌ أَلْوَانُهُ ۗ كَذَلِكَ ۗ إِنَّمَا يَخْشَى اللَّهَ مِنْ عِبَادِهِ

3. Zoti ashtu siç u mundëson të gjithë popujve të botës rrethanat dhe mjetet e jetesës për trupin, në të njëjtën mënyrë, ai i bekoj ata të gjithë edhe me mjetet e jetesës shpirtërore, siç e pohon edhe në këtë ajet, që nuk ka popull që të mos i ketë ardhur ndonjë Profet a i Dërguar prej Zotit. Mëshira e Zotit është e përgjithshme dhe që mbulon të gjithë popujt, të gjitha kombet dhe të gjitha kohërat. Kjo në mënyrë që asnjë popull të mos ketë nevojë të ankohet që – pse Zoti e bekoj atë popull e jo ne?! Pra, Ai manifestoi mëshirë të përgjithshme, dhe ky pikërisht është morali i lartë i Tij që Ai na ka mësuar edhe neve. Ky parim fisnik të bën të besosh se të gjitha fetë kanë pasur një origjinë Hyjnore dhe se themeluesit e feve të tyre ishin të Dërguar të Zotit, edhe pse, me kalimin e kohës, shumica e këtyre feve kanë pësuar ndryshime nga ndërhyrjet e njeriut. Lexoni edhe 40:79.

që janë të ditur.<sup>4</sup> Sigurisht, Allahu është Mbizotërues, shumë Falës.

الْعُلَمَاءُ إِنَّ اللَّهَ عَزِيزٌ غَفُورٌ ﴿٣٠﴾

30. Ata që lexojnë Librin e Allahut, falin namazin dhe shpenzojnë fshehtas e haptas nga ajo që Ne u kemi dhënë, shpresojnë në një tregti që kurrë nuk humbet.

إِنَّ الَّذِينَ يَتْلُونَ كِتَابَ اللَّهِ وَأَقَامُوا الصَّلَاةَ  
وَأَنفَقُوا مِمَّا رَزَقْنَاهُمْ سِرًّا وَعَلَانِيَةً يَرْجُونَ  
تِجَارَةً تَنْ تَبُورًا ﴿٣٠﴾

31. Që Ai t'ua japë shpërblimet e tyre në mënyrë të plotë dhe t'ua shtojë edhe më shumë bekimin e Tij. Sigurisht, Ai është shumë Falës, shumë Mirënjohës.

لِيُؤْفِقَهُمْ أَجْرَهُمْ وَيَزِيدَهُمْ مِّنْ  
فَضْلِهِ ۗ إِنَّهُ غَفُورٌ شَكُورٌ ﴿٣١﴾

32. Ajo që Ne të kemi shpallur ty nga Libri është e vërteta (dhe) vërtetuese e asaj që është para saj. Pa dyshim, Allahu është i Gjithinformuar (dhe) Gjithëshikues për robërit e Tij.

وَالَّذِي أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ مِنَ الْكِتَابِ هُوَ الْحَقُّ  
مُصَدِّقًا لِّمَا بَيْنَ يَدَيْهِ ۗ إِنَّ اللَّهَ بِعِبَادِهِ لَخَبِيرٌ  
بَصِيرٌ ﴿٣٢﴾

33. Më pas, ua trashëguam Librin atyre që zgjodhëm prej robërve Tanë. Prej tyre ka nga ata që janë të padrejtë për shpirtin e vet, po prej tyre ka nga ata që ndjekin rrugën e ndërmjetme, dhe ka edhe nga ata prej tyre, të cilët janë parakalues në mirësi me urdhrin e Allahut. Ky pikërisht është bekimi i madh.<sup>5</sup>

ثُمَّ أَوْرَثْنَا الْكِتَابَ الَّذِينَ اصْطَفَيْنَا مِنْ  
عِبَادِنَا ۖ فَمِنْهُمْ ظَالِمٌ لِّنَفْسِهِ ۖ وَمِنْهُمْ  
مُقْتَصِدٌ ۖ وَمِنْهُمْ سَابِقٌ بِالْخَيْرَاتِ ۖ يُؤْتِي  
اللَّهُ ذُلِكَ هُوَ الْفَضْلُ الْكَبِيرُ ﴿٣٣﴾

4. Ky ajet tregon që ata të cilët nuk kanë takva, pra, druajtje dhe frikë ndaj Allahut, kurrsesi nuk mund të posedojnë titullin për të qenë dijetar. Atyre që Zoti u dhuron njohjen e vërtetë të Tij dhe dijen që u sjell druajtjen ndaj Tij, janë ata për të cilët Profeti<sup>savs</sup> tha: “dijetarët e *umetit* tim janë si Profetët e bijve të Izraelit.” (Razi, “Mefatihul-Gajb”, vëll. XIX, kom. 14:13, botues: “Darul-Fikr”, Bejrut 1981, fq. 99.)

5. Besimtarët kanë nivele të ndryshme. Në nivelin e ulët janë ata që ende janë të përfshirë në mëkate, por që mundohen ta mposhtin *nefsin* e tyre *amarah* (shpirtin që nxit për të keqen), për ta sjellë atë në rrugë të Zotit. Në nivelin e mesëm janë ata që ndjekin rrugën e ndërmjetme dhe në nivelin e lartë janë ata që i parakalojnë të tjerët në veprat e mira. Lexoni edhe 12:54.

34. Xhenete të përjetshme janë (vendi) ku do të hyjnë ata, ku ata do të vishen me byzylykë ari dhe margaritarë. Dhe veshja e tyre atje do të jetë prej mëndafshi.

جَبَّتْ عَدْنٌ يَدْخُلُونَهَا يُجَلَّلُونَ فِيهَا مِنْ  
أَسَاوِرَ مِنْ ذَهَبٍ وَلُؤْلُؤًا ۖ وَلِبَاسُهُمْ فِيهَا  
حَرِيرٌ ﴿٣٤﴾

35. Ata do të thonë: “Lavdia është e Allahut që na largoi brengën. Pa dyshim, Zoti ynë është shumë Falës, shumë Mirënjohës.

وَقَالُوا الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي أَذْهَبَ عَنَّا الْحَزْنَ ۖ  
إِنَّ رَبَّنَا لَغَفُورٌ شَكُورٌ ﴿٣٥﴾

36. I cili na pruri me bekimin e Tij në shtëpinë e përjetësisë; këtu nuk na prek mundimi dhe këtu nuk na prek as lodhja.”

الَّذِي أَحَلَّنَا دَارَ الْمَقَامَةِ مِنْ فَضْلِهِ ۗ لَّا  
يَمَسُّنَا فِيهَا نَصَبٌ وَلَا يَمَسُّنَا فِيهَا لُغُوبٌ ﴿٣٦﴾

37. Dhe ata që mohuan do të kenë zjarrin e xhehenemit. Nuk do të dekretohet për ta që të vdesin, dhe as nuk do t'u pakësohet ndëshkimi i tij. Ne kështu dënojmë çdo mos-mirënjohës.

وَالَّذِينَ كَفَرُوا لَهُمْ نَارُ جَهَنَّمَ ۗ لَّا يُقْضَىٰ  
عَلَيْهِمْ فِيمَوْتُورًا وَلَا يُخَفَّفُ عَنْهُمْ مِنْ  
عَذَابِهَا ۗ كَذٰلِكَ نَجْزِي كُلَّ كٰفُوْرٍ ﴿٣٧﴾

38. Ata do të ulërijnë atje: “O Zoti ynë, na nxirr! Do të bëjmë të mira, ndryshe nga ato që bënim!” A nuk ju kishim dhënë jetë të mjaftueshme, sa mund të merrte mësim ai që donte ta merrte?! Dhe juve ju erdhi edhe alarmuesi. Andaj, shijoni (ndëshkimin)! Keqbërësit nuk kanë asnjë ndihmës!

وَهُمْ يُصْطَرِحُونَ فِيهَا رَبَّنَا أَخْرِجْنَا نَعْمَلْ  
صَالِحًا غَيْرَ الَّذِي كُنَّا نَعْمَلُ ۗ أَوَلَمْ  
نُعَمِّرْكُم مَّا يَتَذَكَّرُ فِيهِ مَنْ تَذَكَّرَ  
وَجَاءَكُمُ التَّذْوِيرُ ۗ فَذُوقُوا فَمَا لِلظَّالِمِينَ  
مِنْ نَّصِيْرٍ ﴿٣٨﴾

39. Pa dyshim, Allahu është i Dijshmi i së padukshmes së qiejve e të tokës. Ai është i Gjithëdijshëm për gjithçka që mbajnë kraharorët.

إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ غَيْبِ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ۗ  
إِنَّهُ عَلِيمٌ بِذَاتِ الصُّدُورِ ﴿٣٩﴾

40. Është Ai që ju bëri mëkëmbës në tokë. Andaj, ai që mohon, mohimi i tij

هُوَ الَّذِي جَعَلَكُمْ خَلَائِفَ فِي الْأَرْضِ ۗ فَمَنْ

do të bjerë kundër vetë atij. Mohimi i mohuesve do t'ua shtojë pranë Zotit të tyre vetëm mospëlqimin (e Tij). Mohimi i mohuesve do t'u shtojë vetëm humbje.

41. Pyet: A i keni parë ortakët tuaj, të cilët i lusnit në vend të Allahut? Më tregoni çfarë krijuan ata prej tokës. Apo mos vallë ata kanë ortakëri (veç) në qiej?! Apo u kemi dhënë Ne ndonjë Libër, që ata qëndruakan mbi ndonjë argument të qartë prej tij?! Jo! Në të vërtetë të padrejtët i premtojnë njëri-tjetrit vetëm mashtrimin.

42. Sigurisht, Allahu po i mban qiejt dhe tokën që të mos lëkunden. Dhe nëse ato lëkunden (një herë), askush nuk mund t'i mbajë më ato përveç Atij. Pa dyshim, Ai është shumë i Durueshëm, shumë Falës.

43. Ata u betuan në Allah dhe forcuan betimet e tyre (duke thënë se), nëse u vjen ndonjë alarmues, patjetër do të udhëzohen më shumë se çdo popull tjetër. E kur u erdhi një alarmues, ai nuk u shtoi asgjë atyre përveç urrejtjes;

44. për shkak të mendjemadhësisë (së tyre) në tokë dhe të dredhive (të tyre) të liga. Dredhia e ligë nuk rrethon tjetërkënd, por vetë planifikuesin e saj. Andaj, a po presin ata ndonjë praktikë tjetër përveç praktikës (që u zbatua) me të parët? Atëherë, ti nuk do të gjesh asnjë ndryshim në praktikën e Allahut, dhe nuk do të gjesh asnjë devijim në praktikën e Allahut.

كَفَرَ فَعَلَيْهِ كُفْرُهُ ۗ وَلَا يُزِيدُ الْكَافِرِينَ  
كُفْرَهُمْ عِنْدَ رَبِّهِمْ إِلَّا مَقْتًا ۚ وَلَا يُزِيدُ  
الْكَافِرِينَ كُفْرَهُمْ إِلَّا خَسَارًا ۝

قُلْ أَرَأَيْتُمْ شُرَكَاءَكُمُ الَّذِينَ تَدْعُونَ  
مِنْ دُونِ اللَّهِ ۗ أَرُونِي مَاذَا خَلَقُوا مِنَ  
الْأَرْضِ أَمْ لَهُمْ شِرْكٌ فِي السَّمَوَاتِ ۚ أَمْ  
أَتَيْنَهُمْ كِتَابًا فَهُمْ عَلَىٰ بَيِّنَاتٍ مِنْهُ ۚ بَلْ  
إِنْ يُعِدُّ الظَّالِمُونَ بَعْضُهُمْ بَعْضًا إِلَّا غُرُورًا ۝

إِنَّ اللَّهَ يُمْسِكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ أَنْ  
تَزُولَا ۗ وَلَئِن زَالَتَا إِنْ أَمْسَكَهُمَا مِنْ أَحَدٍ  
مِّنْ بَعْدِهِ ۗ إِنَّهُ كَانَ حَلِيمًا غَفُورًا ۝

وَأَقْسَمُوا بِاللَّهِ جَهْدَ أَيْمَانِهِمْ لَئِنْ جَاءَهُمْ  
نَذِيرٌ لَّيَكُونُنَّ أَهْلَىٰ مِنْ أَحَدَى الْأُمَمِ ۚ  
فَلَمَّا جَاءَهُمْ نَذِيرٌ مَّا زَادَهُمْ إِلَّا نُفُورًا ۝

اسْتَكْبَارًا فِي الْأَرْضِ وَمَكْرَ السَّيِّئِ ۗ وَلَا  
يَحِيقُ الْمَكْرُ السَّيِّئِ إِلَّا بِأَهْلِهِ ۗ فَهَلْ  
يُنظَرُونَ إِلَّا سُنَّتِ الْأَوَّلِينَ ۚ فَلَنْ تَجِدَ  
لِسُنَّتِ اللَّهِ تَبْدِيلًا ۗ وَكَانَ تَجِدَ لِسُنَّتِ اللَّهِ  
حَوِيلًا ۝



45. A nuk kanë shëtitur në tokë që të shihnin si qe fundi i atyre që ishin më parë?! Ata ishin më të fortë se këta. Allahun nuk e mund asgjë në qiej e në tokë. Sigurisht, Ai është i Gjithëdijshëm, i Plotfuqishëm.

46. Dhenëse Allahu dot'indëshkonte njerëzit sipas asaj që ata punuan, Ai nuk do të linte (të mbijetonte) asnjë nga gjallesat në faqen e kësaj (toke). Por Ai u jep lëshim deri në një afat të caktuar. Dhe kur u vjen afati, (do të bëhet e qartë se) Allahu pa dyshim i shikon mirë robërit e Tij.<sup>6</sup>

أَوَلَمْ يَسِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَيَنْظُرُوا كَيْفَ  
كَانَ عَاقِبَةُ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ وَكَانُوا أَشَدَّ  
مِنْهُمْ قُوَّةً ۗ وَمَا كَانَ اللَّهُ لِيُعْجِزَهُ مِنْ  
شَيْءٍ فِي السَّمَوَاتِ وَلَا فِي الْأَرْضِ ۗ إِنَّهُ كَانَ  
عَلِيمًا قَدِيرًا ﴿٤٥﴾

وَلَوْ يُوَازِئُ اللَّهُ النَّاسَ بِمَا كَسَبُوا مَا تَرَكَ  
عَلَى ظَهْرِهَا مِنْ دَابَّةٍ ۗ وَلَكِنْ يُؤَخَّرُهُمْ  
إِلَىٰ آجَلٍ مُّسَمًّى ۚ فَاِذَا جَاءَ آجَلُهُمْ فَإِنَّ  
اللَّهَ كَانَ بِعِبَادِهِ بَصِيرًا ﴿٤٦﴾

6. Ky ajet flet për mëkatet e njerëzve, por si pasojë të tyre, përmend shkatërrimin e gjithë gjallesave, pra edhe të njerëzve, edhe të kafshëve. Nuk është kuptimi se tjetërkush bën, e tjetërkush pëson. Por në të vërtetë, shkatërrimi i kafshëve u sjell shkatërrim edhe njerëzve, pasi jeta e tyre është e ndërlidhur. Nëse asgjësohen bagëtitë, njeriu nuk mund të mbijetojë dot. Fjala *dab-beh* që vjen në këtë ajet përfshin kafshët që lëvizin në sipërfaqen e Tokës. Një arsye tjetër është që qëllimi kryesor i të gjithë krijimit është njeriu, për të cilin Zoti e nënshtroi gjithçka tjetër të kësaj bote. Nëse njeriu do të shkatërrohej menjëherë për mëkatet e tij, do të shkatërrohej e gjithë bota.

## Surja 36 – Ja.Sin.

Surja Ja.Sin. është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka tetëdhjetë e katër ajete.

Në një nga ajetet e fundit të sures paraardhëse (ajeti nr. 43), u përmend premtimi i përbetuar i mohuesve, në të cilin ata thonë se nëse do t'u vijë ndonjë alarmues, do të udhëzohen më mirë se popujt e mëparshëm. Kurse në ajetet e para të sures Ja.Sin., duke iu drejtuar Profetit Muhammed<sup>sav</sup>, Allahu i Madhërishëm i thotë – Ne të dërguam ty te një popull, i cili për një kohë të gjatë nuk pati asnjë alarmues, megjithatë, për shumicën prej tyre, u vërtetua fjala e Allahut që ata nuk do të bëheshin besimtarë. Kështu që, pretendimi i mohuesve që u përmend në fund të sures së kaluar, se nëse atyre do t'u vinte ndonjë alarmues ata do të bëheshin besimtarë, u hodh poshtë në këtë sure.

Pas kësaj, kjo sure përdor një figurshmëri për kundërshtarët e Profetëve duke thënë se është mendjemadhësia e tyre ajo që nuk i lejon të udhëzohen, njësoj si ai që mban të tendosur qafën e tij për shkak të zinxhirëve që ka në të. Prandaj, besimi është një dhuratë që u jepet vetëm atyre që nuk kanë aspak mendjemadhësi.

Për ngjarjet që fillojnë me ajetin nr. 14, komentuesit kanë dhënë shpjegime të ndryshme, por rreth këtyre ajeteve, mua më pëlqen një komentim i bërë nga *Hazret Hakim Mevlana Nuruddini*<sup>ra</sup>, Kalif i Parë i Xhematit Musliman Ahmedia, ku ai thotë – Dy Profetët e përmendur në ajetin nr. 14 e 15, janë *Hazret Musai*<sup>as</sup> dhe *Hazret Isai*<sup>as</sup>. Profeti Muhammed<sup>sav</sup>, i nderoi ata duke i mbështetur. Por për shkak të mohimit të vazhdueshëm të mohuesve, u ngrit një i katërt nga një fshat i largët, i cili i paralajmëroi mohuesit duke thënë – Ai Profet madhështor ju mundëson mjete të panumërta për udhëzimin tuaj dhe vetë nuk ju kërkon asnjë shpërblim, veçse të bëheni besimtarë.

Në kohën kur u zbrit Kurani i Shenjtë, në bimësi, arabët njihnin çifte vetëm të hurmave. Asnjëri prej tyre nuk mund të dinte dot se Allahu i Madhërishëm ka krijuar çifte për të gjitha llojet e pemëve frutore, madje, ajeti nr. 37 deklaroi se çdo gjë e këtij universi është krijuar në çift. Shkenca e sotme tanimë e ka zbuluar këtë fakt, dhe sot ne e dimë që atomet, madje edhe grimcat subatomike kanë çifte të tyre. Pra, tema e çifteve është shumë e gjerë, por edhe e rëndësishme për të kuptuar Njëshmërinë e Zotit. Është vetëm Krijuesi i universit që është i pavarur nga çifti, kurse i gjithë krijimi është krijuar në çift.

Pas kësaj, në një ajet të kësaj sureje, u përmend edhe një herë tema e rilindjes dhe u tregua skena e të vdekurve që ringjallen në kohën e rilindjes dhe që shprehin habinë e tyre duke thënë – Kush është Ai që na ringjalli? Atyre u jepet përgjigja – Të Dërguarit e Allahut ju kanë thënë të vërtetën.

Ajeti nr. 81 flet për një pemë të gjelbëruar e që lëshon zjarr. Komentuesit thonë se pema kur thahet, bëhet lëndë djegëse dhe lëshon zjarr. Edhe kjo qëndron. Por

nganjëherë edhe pemët e gjelbëruara shkaktojnë zjarr. Këtë e thonë edhe shkencëtarët për pishat, se kur ato përplasen me njëra-tjetrën për shkak të erërave të forta, mund të marrin flakë duke shkaktuar zjarr dhe kështu sipërfaqe shumë të mëdha pyjore shkrumbohen.

Edhe ajeti i fundit i kësaj sureje flet për ringjalljen duke pohuar – Çdo gjë në univers është nën sundimin e Allahut, dhe, o njerëz, edhe ju tek Ai do të ktheheni.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. *Ja.Sin.* (O udhëheqës!)

يَسُف ②

3. Beto hem për Kuranin Urtilplotë!

وَالْقُرْآنِ الْحَكِيمِ ③

4. Pa dyshim, ti je ndër të Dërguarit

إِنَّكَ لَمِنَ الْمُرْسَلِينَ ④

5. (Qëndron) në rrugë të drejtë.

عَلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ ⑤

6. (Kjo) zbritje (e shpalljeve) është nga Mbizotëruesi, Mëshirëbërësi.

تَنْزِيلَ الْعَزِيزِ الرَّحِيمِ ⑥

7. Që të paralajmërosh një popull, etërit e të cilit nuk janë paralajmëruar, andaj janë të shkujdesur.

لِيُنذِرَ قَوْمًا مَّا أُنذِرَ آبَاؤَهُمْ فَهُمْ غَافِلُونَ ⑦

8. Sigurisht, për shumicën prej tyre u vërtetua fjala, andaj ata nuk do të besojnë.

لَقَدْ حَقَّ الْقَوْلُ عَلَىٰ أَكْثَرِهِمْ فَهُمْ لَا يُؤْمِنُونَ ⑧

9. Ne u kemi vënë në qafë prangat që u vijnë deri te mjekrat, andaj ata po e mbajnë kokën lart.

إِنَّا جَعَلْنَا فِي أَعْنَاقِهِمْ أَغْلَالًا فَهِيَ إِلَى الْأَذْقَانِ فَهُمْ مُقْمَحُونَ ⑨

10. Dhe u kemi vendosur një pengesë para tyre dhe një pengesë mbrapa tyre dhe (po ashtu) u kemi vënë perde, prandaj ata nuk shohin.<sup>1</sup>

وَجَعَلْنَا مِنْ بَيْنِ أَيْدِيهِمْ سَدًّا وَمِنْ خَلْفِهِمْ سَدًّا فَأَعْشَيْنَاهُمْ فَهُمْ لَا يُبْصِرُونَ ⑩

1. Ajetet 9 – 10: Mohuesit nuk kanë pranga të dukshme dhe as ata nuk janë fizikisht të verbër. Prandaj, këto fjalë pa dyshim janë të figurshme dhe kuptimi i tyre është që ata kanë pranga që i pengojnë nga veprat e mira dhe shpirtërisht janë të verbër.

11. Dhe është njësoj për ta, në daç i alarmon, në daç nuk i alarmon, ata nuk besojnë.

وَسَوَاءٌ عَلَيْهِمْ ءَأَنْذَرْتَهُمْ أَمْ لَمْ تُنذِرْهُمْ لَا يُؤْمِنُونَ ﴿١١﴾

12. Ti mund të alarmosh vetëm atë që pranon këshillën dhe i frikësohet të Gjithëmëshirshmit (edhe) kur është i vetëm. Atij jepi lajmin e mirë për falje dhe për një shpërblim të nderuar.

إِنَّمَا تُنذِرُ مَنِ اتَّبَعَ الذِّكْرَ وَخَشِيَ الرَّحْمَنَ بِالْغَيْبِ ۖ فَبَشِّرْهُ بِمَغْفِرَةٍ وَأَجْرٍ كَرِيمٍ ﴿١٢﴾

13. Pa dyshim, Ne i ringjallim të vdekurit dhe shkruajmë gjithçka që ata (bëjnë dhe) dërgojnë për të ardhmen, dhe (shkruajmë edhe) gjurmët e tyre. Çdo gjë e kemi ruajtur në një udhërrëfim të qartë.

إِنَّا نَحْنُ نُحْيِي الْمَوْتَىٰ وَنَكْتُبُ مَا قَدَّمُوا وَآثَارَهُمْ ۚ وَكُلَّ شَيْءٍ أَحْصَيْنَاهُ فِي إِمَامٍ مُّبِينٍ ﴿١٣﴾

14. Tregoju atyre shembullin e banorëve të fshatit, kur në të erdhën të Dërguarit;

وَاصْرِبْ لَهُم مَّثَلًا أَصْحَابَ الْقَرْيَةِ ۚ إِذْ جَاءَهَا الْمُرْسَلُونَ ﴿١٤﴾

15. kur Ne u dërguam dy (të Dërguar), të cilët ata i quajtën gënjeshtarë. Atëherë forcuam me një të tretë, e ata thanë: “Ne pa dyshim jemi të dërguar për ju.”

إِذْ أَرْسَلْنَا إِلَيْهِمُ اثْنَيْنِ فَكَذَّبُوهُمَا فَعَزَّزْنَا بِثَالِثٍ فَقَالُوا إِنَّا إِلَيْكُمْ مُّرْسَلُونَ ﴿١٥﴾

16. (Banorët) thanë: “Nuk jeni asgjë përveçse njerëz sikur ne dhe as i Gjithëmëshirshmi nuk zbriti ndonjë gjë; në të vërtetë, ju vetëm po gënjeni.”

قَالُوا مَا أَنْتُمْ إِلَّا بَشَرٌ مِّثْلُنَا ۚ وَمَا أَنْزَلَ الرَّحْمَنُ مِنْ شَيْءٍ ۚ إِنْ أَنْتُمْ إِلَّا تَكْذِبُونَ ﴿١٦﴾

17. (Të Dërguarit) thanë: “Zoti ynë e di që ne sigurisht jemi të dërguar për ju.

قَالُوا رَبَّنَا يَعْلَمُ إِنَّا إِلَيْكُمْ لَمُرْسَلُونَ ﴿١٧﴾

18. Dhe ne nuk kemi asnjë përgjegjësi, përveç kumtimit të qartë.”

وَمَا عَلَيْنَا إِلَّا الْبَلَاغُ الْمُبِينُ ﴿١٨﴾

19. Ata thanë: “Ne ju shohim një ogur të keq. Nëse nuk tërhiqeni, patjetër do t’ju gurëzojmë dhe ju do të merrni nga ne një ndëshkim të dhimbshëm.”

قَالُوا إِنَّا تَطَيَّرْنَا بِكُمْ ۗ لَئِن لَّمْ تَنْتَهُوا  
لَنَرْجُمَنَّكُمْ وَلَيَمَسَّنَّكُم مِّنَّا عَذَابٌ  
أَلِيمٌ ﴿١٩﴾

20. Ata thanë: “Ogurzia juaj është me ju. Nëse do t’ju jepet një këshillë e mirë (a do të kundërshtoni sërish?!) Në të vërtetë, jeni njerëz që e teproni.”

قَالُوا طَائِرُكُمْ مَعَكُمْ ۗ إِنَّ دُكْرَكُمْ  
بَلْ أَنْتُمْ قَوْمٌ مُّسْرِفُونَ ﴿٢٠﴾

21. Një njeri erdhi duke vrapuar nga një cep i largët i qytetit (dhe) tha: “O populli im! Ndiqini të Dërguarit!

وَجَاءَ مِنْ أَقْصَا الْمَدِينَةِ رَجُلٌ يَسْعَى قَالَ  
يَقَوْمِ اتَّبِعُوا الْمُرْسَلِينَ ﴿٢١﴾

22. Ndiqini ata që nuk ju kërkojnë ndonjë shpërblim e që janë të udhëzuar edhe vetë.

اتَّبِعُوا مَنْ لَا يَسْأَلُكُمْ أَجْرًا وَهُمْ  
مُهْتَدُونَ ﴿٢٢﴾

Xhuzi 23

23. E ç’më ndodhi mua që të mos adhuroj Atë që më krijoi?! Edhe ju tek Ai do të ktheheni.

وَمَا لِي لَا أَعْبُدَ الَّذِي فَطَرَنِي وَإِيَّاهُ  
تُرْجَعُونَ ﴿٢٣﴾

24. A të marr zota të tjerë duke e lënë Atë, të Gjithëmëshirshmin, i cili po të dojë të më sjellë dëm, ndërmjetësimi i tyre (pra, i zotave) nuk do të më ndihmojë aspak dhe ata as nuk mund të më lirojnë?!

أَأَتَّخِذُ مِنْ دُونِهِ آلِهَةً إِنْ يُرِدْنِ الرَّحْمَنُ  
بُصْرًا لَّا تَعْنِي عَنِّي شَفَاعَتُهُمْ شَيْئًا وَلَا  
يُنْفَعُونَنِي ﴿٢٤﴾

25. Atëherë do të isha vërtet në humbje të qartë.

إِنِّي إِذَا لَفِئْتُ ضَلَّلٍ مُّبِينٍ ﴿٢٥﴾

26. Sigurisht, unë e besova Zotin tuaj, andaj, më dëgjoni.”

إِنِّي آمَنْتُ بِرَبِّكُمْ فَاسْمِعُونِ ﴿٢٦﴾

27. Atij iu tha: “Hyr në xhenet!” Ai tha: “Ah, sikur të dinte populli im,

قِيلَ ادْخُلِ الْجَنَّةَ ۗ قَالَ يَلَيْتَ قَوْمِي  
يَعْلَمُونَ ﴿٢٧﴾

28. sesi Zoti im më fali mua dhe më bëri ndër të nderuarit!”

29. Pas asaj, Ne nuk zbritëm mbi popullin e tij ndonjë ushtri prej qiellit dhe as nuk do të zbrisnim (diçka të tillë).

30. Ai ishte një gjëmim i vetëm dhe ata befasi u shuan.

31. Çfarë mjerimi për robërit! Çdoherë që u vjen ndonjë i dërguar, ata e përqeshin!

32. A nuk e kanë parë se sa shumë brezni kemi shkatërruar përpara tyre?! Pa dyshim, ata nuk do të kthehen te këta;

33. dhe që të gjithë do të paraqiten pranë Nesh.

34. Një shenjë për ta është edhe toka e vdekur, të cilën Ne e gjallëruam dhe nxorëm prej saj (çdolloj) fare dhe po me atë ata ushqehen.

35. Në të krijuam edhe pemishte prej hurmash dhe vreshta, çamë edhe burime prej saj.

36. Që ata të hanin frutat e Tij dhe gjithashtu nga ajo që duart e tyre punuan. Atëherë, a nuk falënderojnë?!

37. I Shenjtë është Ai që krijoi çifte të çdollojshme, prej atyre që nxjerr toka, prej vetes së tyre dhe prej asaj që ata nuk dinë.

بِمَا غَفَرْنَا لِي رَبِّيَّ وَجَعَلَنِي مِنَ  
الْمُكْرَمِينَ ﴿٢٨﴾

وَمَا أَنْزَلْنَا عَلَى قَوْمِهِ مِنْ بَعْدِهِ مِنْ جُنْدٍ  
مِنَ السَّمَاءِ وَمَا كُنَّا مُنْزِلِينَ ﴿٢٩﴾

إِنْ كَانَتْ إِلَّا صَيْحَةً وَاحِدَةً فَإِذَا هُمْ  
خَامِدُونَ ﴿٣٠﴾

يَحْسِرَةَ عَلَى الْعِبَادِ ۗ مَا يَأْتِيهِمْ مِنْ رَسُولٍ  
إِلَّا كَانُوا بِهِ يَسْتَهْزِئُونَ ﴿٣١﴾

الْمَيْرُوا كَمْ أَهْلَكْنَا قَبْلَهُمْ مِنَ الْقُرُونِ  
أَنَّهُمْ إِلَيْهِمْ لَا يَرْجِعُونَ ﴿٣٢﴾

وَإِنْ كُلُّ لَمَّا جَمِيعٌ لَدَيْنَا مُحْضَرُونَ ﴿٣٣﴾

وَآيَةٌ لَهُمُ الْأَرْضُ الْمَيْتَةُ ۖ أَحْيَيْنَاهَا  
وَأَخْرَجْنَا مِنْهَا حَبًّا فَمِنْهُ يَأْكُلُونَ ﴿٣٤﴾

وَجَعَلْنَا فِيهَا جَنَّاتٍ مِنْ نَجِيلٍ وَأَعْنَابٍ وَ  
فَجَّرْنَا فِيهَا مِنَ الْعُيُونِ ﴿٣٥﴾

لِيَأْكُلُوا مِنْ ثَمَرِهِ ۚ وَمَا عَمِلَتْهُ أَيْدِيهِمْ  
أَفَلَا يَشْكُرُونَ ﴿٣٦﴾

سُبْحَانَ الَّذِي خَلَقَ الْأَرْوَاجَ كُلَّهَا مِمَّا  
تُثْبِتُ الْأَرْضُ وَمِنْ أَنْفُسِهِمْ وَمِمَّا  
لَا يَعْلَمُونَ ﴿٣٧﴾

38. Një shenjë për ta është edhe nata, prej së cilës tërheqim ditën dhe ata përnjëherë mbeten në errësirë.

وَآيَةٌ لَهُمُ اللَّيْلُ نَسْلَخُ مِنْهُ النَّهَارَ  
فَإِذَا هُمْ مُظْلِمُونَ ﴿٣٨﴾

39. Dhe dielli lundron drejt destinacionit të tij. Ky është caktimi i të Gjithëfuqishmit, i të Gjithë-dijshmit.

وَالشَّمْسُ تَجْرِي لِمُسْتَقَرٍّ لَهَا ۗ ذَلِكَ  
تَقْدِيرُ الْعَزِيزِ الْعَلِيمِ ﴿٣٩﴾

40. Edhe hënës i kemi caktuar faza, derisa ajo kthehet si degë e vjetër hurme.

وَالْقَمَرَ قَدَرْنَاهُ مَنَازِلَ حَتَّىٰ عَادَ  
كَالْعُرْجُونِ الْقَدِيمِ ﴿٤٠﴾

41. Dielli nuk ka fuqi ta zërë hënën dhe as nata nuk mund të parakalojë ditën. Secili po lundron në një orbitë (të vet).<sup>2</sup>

لَا الشَّمْسُ يَنْبَغِي لَهَا أَنْ تُدْرِكَ الْقَمَرَ  
وَلَا اللَّيْلُ سَابِقُ النَّهَارِ ۗ وَكُلٌّ فِي فَلَكٍ  
يَسْبَحُونَ ﴿٤١﴾

42. Një shenjë për ta është edhe kjo që Ne i hipëm pasardhësit e tyre (pra, të njerëzve) në një anije të mbushur.

وَآيَةٌ لَهُمْ أَنَّا حَمَلْنَا ذُرِّيَّتَهُمْ فِي الْفَلَكِ  
الْمُسْحُونِ ﴿٤٢﴾

43. Kemi krijuar për ta edhe (mjete) të tjera si ajo, në të cilat ata do të udhëtojnë.

وَخَلَقْنَا لَهُمْ مِنْ مِثْلِهِ مَا يَرْكَبُونَ ﴿٤٣﴾

44. Po të duam, do t'i fundosim, saqë ata nuk do të gjejnë dikë t'i kërkojnë ndihmë dhe as nuk do të shpëtojnë dot;

وَإِنْ نَشَاءُ نُغْرِقْهُمْ فَلَا صَرِيحَ لَهُمْ وَلَا هُمْ  
يُنْقَذُونَ ﴿٤٤﴾

2. Ajetet 39–41 zbulojnë disa fakte të kozmosit, të cilat një i pashkolluar i Arabisë nuk mund t'i dinte në asnjë mënyrë, përveçse nga Zoti i Gjithëdijshëm. Mostakimi i diellit dhe i hënës është diçka që e shohim të gjithë, por për pyetjen pse hëna ndërro format, zvogëlohet e zmadhohet, këto ajete tregojnë se ndodh për shkak të lëvizjes së trupave qiellorë. Për më tepër thuhet këtu se edhe dielli lundron drejt një destinacioni të caktuar. Një kuptim i këtyre fjalëve është që dielli dikur do të arrijë moshën e vet dhe do të asgjësohet. Dhe kuptimi tjetër është ai që shkencëtarët e sotëm e kanë zbuluar, që dielli bashkë me trupat e tij qiellorë, pra me gjithë sistemin diellor, po lëviz në një drejtim të caktuar. Kjo gjithashtu do të thotë se i gjithë universi është në lëvizje në atë mënyrë që trupat qiellorë ruajnë edhe distancën me njëri-tjetrin. Këto zbulime në shkencë u bënë vetëm në dekadat e fundit. Mund të shtojmë edhe diçka që e gjithë kjo provon se universi ynë po lëviz për shkak të gravitetit të një universi tjetër të panjohur.



45. përveçse me mëshirë prej Nesh dhe për të përfituar për një kohë të shkurtër.

46. Dhe kur u thuhet: Kini druajtje (ndaj Zotit) në çështjet që keni përpara dhe në ato që keni mbrapa, që të mëshiroheni, (ata nuk i kushtojnë rëndësi).

47. Nuk u vjen ndonjë shenjë nga shenjat e Zotit të tyre, që ata nuk e shmangin.

48. Dhe kur u thuhet: Shpenzoni nga ajo që Allahu ju ka dhuruar, ata që mohuan u thonë atyre që besuan: “A t’i ushqejmë ata, të cilët Allahu Vetë do t’i ushqente, po të donte?! Qenkeni në një devijim të qartë!”

49. Dhe pyesin: “Kur plotësohet ky premtim, nëse jeni të vërtetë?”

50. Ata nuk presin asgjë tjetër përveç një gjëmimi të vetëm, që do t’i zërë kur ata do të jenë duke u grindur.

51. Atëherë nuk do të kenë mundësi as të lënë ndonjë testament dhe as të kthehen te familjet e tyre.

52. Dhe do t’i fryhet bririt dhe befas ata do të dalin nga varret duke vrapuar drejt Zotit të tyre.

53. Do të thonë: “Mjerë ne! Kush na ngriti nga shtretërit tanë? Po kjo qenka ajo që kishte premtuar

إِلَّا رَحْمَةً مِنَّا وَمَتَاعًا إِلَىٰ حِينٍ ﴿٤٥﴾

وَإِذَا قِيلَ لَهُمُ اتَّقُوا مَا بَيْنَ أَيْدِيكُمْ وَمَا خَلْفَكُمْ لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ ﴿٤٦﴾

وَمَا تَأْتِيهِمْ مِنْ آيَةٍ مِنْ آيَاتِ رَبِّهِمْ إِلَّا كَانُوا عَنْهَا مُعْرِضِينَ ﴿٤٧﴾

وَإِذَا قِيلَ لَهُمُ انْفِقُوا مِمَّا رَزَقَكُمُ اللَّهُ قَالِ الَّذِينَ كَفَرُوا لِلَّذِينَ آمَنُوا أَنْطَعِمُ مَنْ نَوْءُ يَسَاءَ اللَّهُ أَطَعَمَهُمْ ۗ إِنَّ أَنْتُمْ إِلَّا فِي ضَلَالٍ مُبِينٍ ﴿٤٨﴾

وَيَقُولُونَ مَتَىٰ هَذَا الْوَعْدُ إِنْ كُنْتُمْ صَادِقِينَ ﴿٤٩﴾

مَا يَنْظُرُونَ إِلَّا صَيْحَةً وَاحِدَةً تَأْخُذُهُمْ وَهُمْ يَخِصِّمُونَ ﴿٥٠﴾

فَلَا يَسْتَطِيعُونَ تَوْصِيَةً وَلَا إِلَىٰ أَهْلِهِمْ يَرْجِعُونَ ﴿٥١﴾

وَنُفِخَ فِي الصُّورِ فَإِذَا هُمْ مِنَ الْأَجْدَاثِ إِلَىٰ رَبِّهِمْ يَنْسِلُونَ ﴿٥٢﴾

قَالُوا يٰوَيْلَنَا مَنْ بَعَثَنَا مِنْ مَرْقَدِنَا ۗ هَذَا مَا وَعَدَ الرَّحْمَنُ وَصَدَقَ ٱلَّذِينَ ءُوقِفُوا ٱلْأَجْرَ ۗ

i Gjithëmëshirshmi, dhe (edhe) të Dërguarit e paskëshin thënë të vërtetën!”

الْمُرْسَلُونَ ﴿٢٧﴾

54. Ai do të jetë një gjësim i vetëm dhe ata, që të gjithë, papritmas do të jenë të paraqitur pranë Nesh.

إِنْ كَانَتْ إِلَّا صَيْحَةً وَاحِدَةً فَإِذَا هُمْ جَمِيعٌ لَدَيْنَا مُحْضَرُونَ ﴿٢٨﴾

55. Pra, sot asnjë shpirti nuk do t'i bëhet aspak padrejtësi dhe ju do të shpërbleheni vetëm për atë që keni bërë.

فَالْيَوْمَ لَا تُظَلَمُ نَفْسٌ شَيْئًا وَلَا تُجْرَوْنَ إِلَّا مَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ ﴿٢٩﴾

56. Sot, pa dyshim, banorët e xhenetit do të argëtohen me zbavitje të ndryshme.

إِنَّ أَصْحَابَ الْجَنَّةِ الْيَوْمَ فِي شُغْلٍ فَاكِهِونَ ﴿٣٠﴾

57. Ata dhe bashkëshortet e tyre do të jenë në hije, të mbështetur nëpër frone të zbukuruara.

هُمْ وَأَزْوَاجُهُمْ فِي ظِلِّ عَلَى الْأَرَائِكِ مُتَّكِنُونَ ﴿٣١﴾

58. Ata atje do të kenë fruta; atje do të kenë çdo gjë që kërkojnë.

لَهُمْ فِيهَا فَاكِهَةٌ وَلَهُمْ مَا يَدْعُونَ ﴿٣٢﴾

59. “Paqe!”, do t’u thuhet nga Zoti shumë Mëshirëbërës.<sup>3</sup>

سَلَامٌ قَوْلًا مِنْ رَبِّ رَحِيمٍ ﴿٣٣﴾

60. “Dhe o keqberës! Ju sot ndahuni tërësisht!

وَأَمَّا زُورًا الْيَوْمَ أَيُّهَا الْمُجْرِمُونَ ﴿٣٤﴾

61. A nuk ju kisha porositur, o bijtë e Ademit – Mos adhuroni djallin se ai, pa dyshim, është armiku juaj i hapur;

أَلَمْ أَعْهَدْ إِلَيْكُمْ يَا بَنِي آدَمَ أَنْ لَا تَعْبُدُوا الشَّيْطَانَ إِنَّهُ لَكُمْ عَدُوٌّ مُبِينٌ ﴿٣٥﴾

62. dhe Më adhuroni Mua; kjo është rruga e drejtë!

وَأَنِ اعْبُدُونِي هَذَا صِرَاطٌ مُسْتَقِيمٌ ﴿٣٦﴾

وقولاً

3. Selami i vërtetë është ai që vjen prej Zotit. Ishte pikërisht selami i Zotit që nxori Hazret Ibrahim<sup>as</sup> të sigurt (*selam*) edhe nga zjarri. Ai që nuk gëzon selam prej Zotit, atij robërit edhe sikur t’i dërgojnë një mijë selame, ato nuk i bëjnë dobi.

63. Por ai ka devijuar një pjesë të madhe prej jush. A nuk patët mend?!

وَلَقَدْ أَصَلَّ مِنْكُمْ جِبِلًّا كَثِيرًا أَفَلَمْ  
تَكُونُوا تَعْقِلُونَ ﴿٦٣﴾

64. Ja ku është xhehenemi që ju ishte premtuar.

هَذِهِ جَهَنَّمُ الَّتِي كُنْتُمْ تُوعَدُونَ ﴿٦٤﴾

65. Sot hyni në të për shkak se mohonit.”

إِصْلَوْهَا الْيَوْمَ بِمَا كُنْتُمْ تَكْفُرُونَ ﴿٦٥﴾

66. Sot Ne do t'ua vulosim gojët, dhe duart e tyre do të Na flasin, këmbët e tyre do të dëshmojnë për atë që ata punonin.<sup>4</sup>

الْيَوْمَ نَخْتِمُ عَلَىٰ أَفْوَاهِهِمْ وَتُكَلِّمُنَا  
أَيْدِيهِمْ وَتَشْهَدُ أَرْجُلُهُمْ بِمَا كَانُوا  
يَكْسِبُونَ ﴿٦٦﴾

67. Po të donim, do t'ua kishim verbuar sytë dhe ata do të nxitoheshin për të gjetur rrugën, por a do të mund ta shihnin, vallë?!

وَلَوْ نَشَاءُ لَطَمَسْنَا عَلَىٰ أَعْيُنِهِمْ فَاسْتَبَقُوا  
الصِّرَاطَ فَأَنَّى يُبْصِرُونَ ﴿٦٧﴾

68. Dhe po të donim, do t'i shpërfytyronim ata në shtëpitë e tyre, sa nuk do të kishin mundësi as të ecnin dhe as të ktheheshin.

وَلَوْ نَشَاءُ لَمَسَخْنَاهُمْ عَلَىٰ مَكَانَتِهِمْ فَمَا  
يَسْتَطَاعُونَ مُضِيًّا وَلَا يَرْجِعُونَ ﴿٦٨﴾

69. Ne ia pakësojmë aftësitë atij që i japim jetë të gjatë. A nuk kuptojnë?!

وَمَنْ لَّعَمْرَهُ نُنكَسُهُ فِي الْخَلْقِ أَفَلَا  
يَعْقِلُونَ ﴿٦٩﴾

70. (Profetit) nuk ia mësuam poezinë dhe as që i duhet. Ky (Libër) është vetëm një këshillë dhe Kuran i qartë;

وَمَا عَلَّمْنَاهُ الشِّعْرَ وَمَا يَنْبَغِي لَهُ ۗ إِنْ هُوَ  
إِلَّا ذِكْرٌ وَقُرْآنٌ مُّبِينٌ ﴿٧٠﴾

71. që ai të alarmojë çdokënd që është i gjallë, dhe që të vërtetohet

لِيُنذِرَ مَنْ كَانَ حَيًّا وَيَحِقُّ الْقَوْلَ عَلَىٰ

4. Llogaridhënia që do të bëhet Ditën e Gjykimit, nuk do të jetë vetëm në bazë të dëshmimeve të engjëjve, por vetë gjymtyrët e njeriut do të rrëfejnë mëkatet që ka bërë njeriu me anë të tyre. Me një fjalë, atë ditë njeriu vetë do të pranojë fajet e tij. Sistemi i drejtësisë së Zotit, i paraqitur nga Kurani i Shenjtë, është shumë i fuqishëm. Do të ketë edhe dëshmitarë, edhe rrëfime të gjynaheve nga vetë gjynahqarët.

fjala kundër mohuesve.<sup>5</sup>

الْكَافِرِينَ ﴿٧١﴾

72. A nuk kanë parë që Ne me Duart Tona krijuam për ta edhe bagëtitë, të cilat ata i zotërojnë?!

أَوَلَمْ يَرَوْا أَنَّا خَلَقْنَا لَهُمْ مِمَّا عَمِلَتْ أَيْدِينَا  
أَنْعَامًا فَهُمْ لَهَا مَلَكَوْنَ ﴿٧٢﴾

73. Dhe ato i nënshtroam për ta. Prej tyre ata kanë (kafshë) për udhëtim dhe prej tyre edhe ushqehen.

وَدَلَّلْنَاهَا لَهُمْ فَمِنْهَا رَكُوبُهُمْ وَمِنْهَا  
يَأْكُلُونَ ﴿٧٣﴾

74. Në to, ata kanë edhe shumë përfitime dhe pije. A nuk falënderojnë?!

وَلَهُمْ فِيهَا مَنَافِعُ وَمَشَارِبٌ ۗ أَفَلَا  
يَشْكُرُونَ ﴿٧٤﴾

75. Ata zgjodhën zota të tjerë përveç Allahut, që ndoshta (prej tyre) të ndihmohen.

وَاتَّخَذُوا مِنْ دُونِ اللَّهِ آلِهَةً لَّعَلَّهُمْ  
يُنصَرُونَ ﴿٧٥﴾

76. (Por zotat) nuk do të kenë mundësi t'i ndihmojnë ata, përkundrazi, do (t'i bëjmë) të paraqiten si ushtri (për të dëshmuar) kundër tyre.

لَا يَسْتَطِيعُونَ نَصْرَهُمْ ۗ وَهُمْ لَهُمْ جُنَدٌ  
مُّحَضَّرُونَ ﴿٧٦﴾

77. Andaj, nuk duhet të të brengosë fjala e tyre. Sigurisht, Ne e dimë çka fshehin ata dhe çka zbulojnë.

فَلَا يَحِزُّكَ قَوْلُهُمْ ۗ إِنَّا نَعْلَمُ مَا يُسْرُونَ  
وَمَا يُعْلِنُونَ ﴿٧٧﴾

78. A nuk ka parë njeriu që Ne e krijuam atë përmes spermës dhe ai, ja, u bë grindavec i hapur;

أَوَلَمْ يَرَ الْإِنْسَانَ أَنَّا خَلَقْنَاهُ مِنْ نُطْفَةٍ  
فَإِذَا هُوَ خَصِيمٌ مُّبِينٌ ﴿٧٨﴾

79. dhe filloi të sajonte shembuj për Ne dhe e harroi krijimin e tij?! Tha: “Kush do t'i ringjallë eshtrat, kur ato të jenë kalbur?”

وَصَرََبَ لَنَا مَثَلًا وَنَسِيَ خَلْقَهُ ۗ قَالَ  
مَنْ يُحْيِي الْعِظَامَ وَهِيَ رَمِيمٌ ﴿٧٩﴾

5. Fjalët “që është i gjallë” nënkuptojnë që nuk është i vdekur shpirtërisht, pra, që është i aftë të marrë e të pranojë mesazhin Hyjnor.

80. Thuaj: Do t'i ringjallë Ai që i krijoi për herë të parë dhe Ai është i Gjithëdijshëm mbi çdolloj krijimi.

قُلْ يُحْيِيهَا الَّذِي أَنْشَأَهَا أَوَّلَ مَرَّةٍ وَهُوَ  
بِكُلِّ خَلْقٍ عَلِيمٌ ﴿٥٠﴾

81. Ai që nga pema e gjelbëruar bëri zjarr për ju, dhe ju prej atij (zjarri) digjni.

الَّذِي جَعَلَ لَكُمْ مِنَ الشَّجَرِ الْأَخْضَرِ نَارًا  
فَإِذَا أَنْتُمْ مِنْهُ تُوقَدُونَ ﴿٥١﴾

82. Ai që krijoi qiejt dhe tokën a nuk është i Plotfuqishëm të krijojë (të tjerë) sikur këta?! Patjetër që po, madje Ai është Krijuesi i madh, i Gjithëdijshmi.

أَوَلَيْسَ الَّذِي خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ  
بِقَدِيرٍ عَلَىٰ أَنْ يَخْلُقَ مِثْلَهُمْ ۚ بَلَىٰ وَهُوَ  
الْخَلَّاقُ الْعَلِيمُ ﴿٥٢﴾

83. Kur Ai vendos diçka, mjafton vetëm urdhri i Tij që të thotë për të: “Bëhu!”, dhe ajo bëhet.

إِنَّمَا أَمْرُهُ إِذَا أَرَادَ شَيْئًا أَنْ يَقُولَ لَهُ كُنْ  
فَيَكُونُ ﴿٥٣﴾

84. Pra, i Shenjtë është Ai në Dorën e të cilit është sundimi i çdo gjëje dhe ju tek Ai do të ktheheni.

فَسُبْحَانَ الَّذِي بِيَدِهِ مَلَكُوتُ كُلِّ شَيْءٍ  
وَإِلَيْهِ تُرْجَعُونَ ﴿٥٤﴾

## Surja 37 – Es-Saffat

Surja Es-Saffat është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka njëqind e tetëdhjetë e tri ajete.

Përpara se të shpjegojmë ajetet e para të kësaj sureje, është e rëndësishme të themi se këto ajete japin disa profeci që mbartin mesazhin se nëse ato përmbushen, edhe ringjallja që është deklaruar fuqimisht, do të realizohet patjetër. Siç Zoti i Madhërishëm pohon në ajetin nr. 12: “Pyeti ata, a jeni ju më të fuqishëm në krijimin tuaj, apo ato që krijuam Ne?” Allahu i Madhërishëm duke iu përgjigjur kësaj pyetjeje, e cila i la të habitur mohuesit, deklaroi se Krijuesi është shumë i Lartë (i Pastër) nga ato qëllime e synime që ju i keni në krijimet tuaja dhe se ju, kur të vdisni dhe pas vdekjes të jeni bërë pluhur, Ai është i Plotfuqishëm t’ju ringjallë nga e para. Njëkohësisht, Zoti ua bëri edhe paralajmërimin duke thënë: “Do të ringjalleni për t’u poshtëruar.” Pra, ata që pretendojnë se janë mjeshtër në krijim dhe e mohojnë krijimin e Allahut të Madhërishëm, do të kuptojnë se krijimet e tyre, në fakt, nuk kanë asnjë vlerë dhe se Krijuesi i Madh është vetëm Allahu i Madhërishëm.

Le t’u kthehemi ajeteve të para të sures, të cilat ndër të tjera parashikojnë edhe avionët luftarakë që do t’i krijonte njeriu, avionë të cilët rreshtohen për të sulmuar armikun dhe u bëjnë thirrje vazhdimisht kundërshtarëve duke hedhur fletushka mbi ta që ata do të vriten, nëse nuk dorëzohen dhe nëse nuk pranojnë nënshtrimin.

Pas kësaj, Allahu i Madhërishëm thotë se çfarë vlere kanë ata që të pretendojnë të jenë zota bazuar vetëm mbi forcën e tyre tokësore?! Allahu është Një dhe i Vetëm.

Më pas tha se Ai është Zoti i Lindjeve. Edhe ky ajet ka një profeci, sepse në kohën e Profetit<sup>savs</sup>, arabët njihnin vetëm një Lindje dhe nuk kishin asnjë koncept për më shumë Lindje, siç e njohim sot. Kjo do të ishte koha kur njeriu përmes shpikjeve të tij ajrore, siç janë raketa dhe anije kozmike, do të tentonte të zbulonte sekretet e Parisë Hyjnore, siç e shohim në kohët tona. Por ajetet thonë se ata nuk do të kenë sukses më shumë sesa të arrijnë disa sekrete vetëm të qiellit të afërt, sepse do të përballen me gurë të fuqishëm që do t’u bien nga çdo anë. Koha jonë dhe shpikjet moderne janë dëshmitare se këto profeci janë përmbushur.

Siç i përmend në ajetet e para luftërat që do të bëheshin mes popujve për pushtete tokësore, kjo sure po ashtu përmend edhe betejat e kohës së Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, të cilat muslimanët do t’i bënin vetëm për hir të Allahut dhe jo për të bërë trazira e gjakderdhje. Madje, muslimanët do të ishin *kurbane* që do të sakrifkoheshin për një kauzë të drejtë gjatë luftës me armikun. Kjo lidhet edhe me sakrificën e *Hazret Ibrahim*<sup>as</sup>, që u tregua i gatshëm për ta therur djalin e tij. Komentuesit mendojnë se fjalët “sakrificë madhore” (arab. *dhibhin adhim*) i referohen një qengji që kishte ngecur aty nëpër shkurre dhe se *Hazret Ismaili*<sup>as</sup> u lirua në këmbim të sakrificës së këtij qengji, mendim ky që është sipërfaqësor dhe, si i tillë, nuk përmendet as në Kuran e as në hadithe. Si mundet që qengji të quhej sakrificë madhore kundrejt

*Hazret Ismailit*<sup>as</sup>?! Realisht, *Hazret Ismaili*<sup>as</sup> u soll dhe u mbajt gjallë atje, në mënyrë që bota të dëshmonte një sakrificë madhore të cilën pasardhësit e tij do të bënin në kohën e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>.

Siç thamë më lart për ajetet e para të kësaj sureje që parashikojnë ushtritë që do të rreshtohen, në fund, Zoti i Madhërisëm gjithashtu thotë – Ushtritë e vërteta janë të Miat. Këtu Kurani përshkruan edhe ushtritë e renditura të Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, si dhe engjëjt të cilët u zbritën të rreshtuar prej qiellit për të ndihmuar sahabët. Kjo u provua në fund të çdo beteje. Ata që ishin të dobët duhet të mundeshin nga armiqtë që ishin më të fortë si në forcë, ashtu edhe në numër. Por nuk ndodhi kështu. Me caktimin e Allahut, fituan Allahu dhe grupi i Tij.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Betohem<sup>1</sup> për (ushtritë) që rreshtohen me radhë!

وَالصَّفَاتِ صَفًّا ①

3. Për ato që ulërijnë duke sulmuar!

فَالزُّجُرَاتِ زَجْرًا ①

4. Për ato që lexojnë mesazhin me zë të lartë!

فَالتَّلَاتِيتِ ذِكْرًا ①

5. Pa dyshim, i Adhureshmi juaj është vetëm Një.<sup>2</sup>

إِنَّ إِلَهَكُمْ لَوَاحِدٌ ①

6. Zoti i qiejve, i tokës dhe i asaj që gjendet mes tyre dhe Zoti i Lindjeve.

رَبُّ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا وَرَبُّ

الْمَسَارِقِ ①

1. Zakonisht njeriu betohet për të sjellë një dëshmi për pohimin e tij dhe duke qenë se nuk ka asnjë dëshmitar, sjell si dëshmitar Zotin e Madhërisëm, sepse Ai është i Dijshmi i së padukshmes dhe Dëshmitari i parë në çdo çështje. Me një fjalë, ai që paraqet dëshminë e Zotit duke u betuar në emër të Tij, pretendon që nëse Zoti nuk do ta dënojë atë, do të thotë se e ka vulosur vërtetësinë e pohimit të tij. Por çfarë nevojë ka Zoti të betohet, aq më tepër për krijesat? Veprat e Zotit në një aspekt mund t'i ndajmë në dy lloje: të parat janë të hapura dhe që i kuptojnë të gjithë dhe askush nuk ka kundërshtime për natyrën e tyre, dhe të dytat janë të tilla që kanë nevojë për arsyetim që duhet zberthyer (deduktiv), ku njerëzit tokësorë gabojnë në domethënien e tyre dhe i kundërshtojnë. Prandaj, Zoti i Madhërisëm në betimet e Tij në Kuran, sjell si dëshmi dukuri ose ngjarje të pranueshme nga të gjithë për të vërtetuar disa të vërteta të ngjashme të botës shpirtërore. Po kështu, betimet e Zotit në Kuranin e Shenjtë vijne edhe si profeci, duke treguar se nëse ndodh kjo, do të ndodhë edhe pohimi tjetër që vjen pas betimit.

2. Fakti që këto ajete nuk pohojnë emra konkretë, por cilësi të caktuara, japin kuptime të ndryshme dhe, njëherësh, përbëjnë edhe profeci. Në fakt, ky stil i Kuranit të Shenjtë gjendet në shumë ajete. Një kuptim i ajeteve të para të kësaj sureje është ai që u përmend në parathënien e sures. Por një kuptim tjetër është se këto që në Mekë, në një kohë kur jo vetëm që nuk kishte filluar lufta, por kur muslimanët jetonin duke duruar persekutimet e ashpra të mekasve, parashikuan virtytet e luftëtarëve muslimanë. Në këtë kontekst, rreshtimi nënkupton rreshtimin e sahabëve të Profetit me një disiplinë të lartë; thirrjet gjatë sulmit nënkuptojnë se ata nuk do të sulmonin fshehtas, leximi i mesazhit me zë të lartë nënkupton leximin e Kuranit ose atë që përmendet në ajetin e radhës. Duhet thënë se këto ajete mund të kenë edhe kuptime të tjera.



7. Sigurisht, Ne zbukuruam qiellin e afërt me yje;

إِنَّا زَيَّيْنَا السَّمَاءَ الدُّنْيَا بِرِيَّةٍ الْكَوَاكِبِ ۝٧

8. si mbrojtje nga çdo djall i mallkuar.

وَحِفْظًا مِنْ كُلِّ شَيْطَانٍ مَّارِدٍ ۝٨

9. Ata nuk mund të dëgjojnë dot Parinë e Lartë dhe do të gjuhen me gurë nga çdo anë.

لَا يَسْمَعُونَ إِلَى الْمَلَاِ الْأَعْلَىٰ وَيُقَذَّفُونَ  
مِنْ كُلِّ جَانِبٍ ۝٩

10. Sepse janë të përzënë dhe do të kenë një ndëshkim ngjitës.

دُحُورًا وَلَهُمْ عَذَابٌ وَاصِبٌ ۝١٠

11. Por ai që rrëmben fshehurazi ndonjë fjalë, edhe atë do ta ndjekë një flakë shpuese.<sup>3</sup>

إِلَّا مَنْ خَطَفَ الْخَطْفَةَ فَاتَّبَعَهُ شِهَابٌ  
ثَاقِبٌ ۝١١

12. Pyeti ata: A janë ata më të fortë në krijim, apo ajo që kemi krijuar Ne? Sigurisht, Ne i krijuam ata me një dhe ngjitës.

فَأَسْتَفْتِهِمْ أَهَمْ أَسَدُّ خَلْقًا أَمْ مِنْ خَلْقِنَا إِنَّا  
خَلَقْنَاهُمْ مِنْ طِينٍ لَازِبٍ ۝١٢

13. Por ti çuditesh, kurse ata tallen.

بَلْ عَجِبْتَ وَيَسْخَرُونَ ۝١٣

3. Ajetet 7–11 tregojnë sistemin e universit, edhe fizik, edhe shpirtëror. Në sistemin e universit fizik, shohim sesí atmosfera e Tokës i ndalon meteorët që bien drejt saj dhe ato që bien, vijnë të shoqëruar me një flakë që i ndjek pas. Po kështu, këto ajete parashikojnë se në të ardhmen njeriu do të përpiqej të marrë lajmet e universit, dhe kjo ndodh vetëm në epokën tonë të anijeve kozmike. Këtu Kurani thotë se ata nuk mund të kapërcejnë dot qiellin e afërt dhe do të sulmohen me gurë nga çdo anë. Në këndvështrimin shpirtëror, po këto ajete tregojnë se ka njerëz dashakëqij që tentojnë të marrin diçka nga shpalljet Hyjnore përmes hamendjeve të tyre. Këta janë quajtur djaj. Djalli në të vërtetë nuk mund t'i afrohet shpalljes Hyjnore dhe zbritjes së saj, por njeriu që ka shpirtin djallëzor, sikurse Samiriu që qe në kohën e Musait<sup>as</sup>, arrin të kuptojë me hamendësimet e tij se shpallja sjell ndikim të jashtëzakonshëm te njerëzit e tjerë, andaj tenton ta kërkojë atë.

Këto ajete kanë edhe kuptime shpirtërore. Nëse besimtari arrin të ngjitet lart, djalli nuk mund ta zërë dot atë. Besimtarit i duhet që t'i lutet Zotit vazhdimisht që Zoti t'i dhurojë një forcë të tillë, me të cilën ai arrin ta mundë djallin. Mendimet e këqija të ndalen vetëm pasi ta shkatërrosh djallin tënd. Besimtari duhet të tregojë qëndrueshmëri, të mos dorëzohet dhe të vijojë luftën e tij kundër djallit. Më në fund, ai e arrin suksesin. Zoti është shumë Mëshirëbërës dhe shumë Bujar. Ata që përpiqen në rrugën e Tij, Ai përfundimisht atyre ua dhuron suksesin. Pra, pozita e lartë e njeriut është që ai ta shkatërrojë djallin. Lexoni edhe 12:54.

14. Kur u jepet këshillë, nuk e pranojnë.

وَإِذَا ذُكِّرُوا لَا يَذْكُرُونَ ﴿١٤﴾

15. Kur shohin ndonjë shenjë, gjejnë (pretekst) për tallje.

وَإِذَا رَأَوْا آيَةً يَسْتَسْخِرُونَ ﴿١٥﴾

16. Dhe thonë: “Kjo qenka një magji e qartë!

وَقَالُوا إِن هَذَا إِلَّا سِحْرٌ مُّبِينٌ ﴿١٦﴾

17. Pasi të vdesim e të bëhemi pluhur dhe eshtra, a do të ngrihemi prapë?!

ءِذَا مِتْنَا وَكُنَّا تُرَابًا وَّ عِطَافًا ءِإِنَّا لَمَبْعُوثُونَ ﴿١٧﴾

18. Vallë, a edhe etërit tanë të parë?!”

أَوَابَاؤُنَا الْأَوَّلُونَ ﴿١٨﴾

19. Thuaj: “Po, madje do të jeni të poshtëruar.”

قُلْ نَعَمْ وَأَنْتُمْ دَاخِرُونَ ﴿١٩﴾

20. Ai do të jetë një qortim i vetëm, dhe ata papritmas do të mbeten syhapur.

فَإِنَّمَا هِيَ زَجْرَةٌ وَاحِدَةٌ فَإِذَا هُمْ يَنْظُرُونَ ﴿٢٠﴾

21. Dhe do të thonë: “Mjerë ne! Kjo qenka Dita e Gjykitimit!”

وَقَالُوا يُوَيْلَنَا هَذَا يَوْمَ الدِّينِ ﴿٢١﴾

22. (Dhe Ne do t’u themi:) “Kjo është dita e vendimit, të cilën ju e quanit gënjeshtër.”

هَذَا يَوْمَ الْفَصْلِ الَّذِي كُنْتُمْ بِهِ تُكَذِّبُونَ ﴿٢٢﴾

23. (Do t’i urdhërojmë engjëjt:) “Mblidhni ata që ishin keqbërës, edhe shokët e tyre, si dhe ato që ata adhuronin;

أَحْشَرُوا الَّذِينَ ظَلَمُوا وَأَزْوَاجَهُمْ وَمَا كَانُوا يَعْبُدُونَ ﴿٢٣﴾

24. duke e lënë Allahun! Drejtojini në rrugën e xhehenemit!

مَنْ دُونِ اللَّهِ فَاهْدُوهُمْ إِلَى صِرَاطِ الْجَحِيمِ ﴿٢٤﴾

25. (Pasi t’i çoni atje,) ndalini pak! Ata do të pyeten”:

وَقِفُّهُمْ إِنَّهُمْ مَسْئُولُونَ ﴿٢٥﴾

26. “Çfarë ju ndodhi (që sot) nuk po ndihmoni njëri-tjetrin?!”

مَا لَكُمْ لَا تَنصُرُونَ ﴿٢٦﴾

27. Madje, ata sot do të pranojnë (çdo mëkat).

بَلْ هُمْ آيَوْمَ مُسْتَسْلِمُونَ ﴿٢٧﴾

28. Do të dalin përpara për të pyetur njëri-tjetrin.

وَأَقْبَلَ بَعْضُهُمْ عَلَىٰ بَعْضٍ يَتَسَاءَلُونَ ﴿٢٨﴾

29. Do të thonë: “Pikërisht ju na vinit nga e djathta (pra, nga ana e fesë për të mashtruar)!”<sup>4</sup>

قَالُوا إِنَّكُمْ كُنْتُمْ تَأْتُونَنَا عَنِ الْيَمِينِ ﴿٢٩﴾

30. Këta do të (përgjigjen) duke thënë: “Por edhe ju nuk keni qenë besimtarë.

قَالُوا بَلْ لَمْ تَكُونُوا مُؤْمِنِينَ ﴿٣٠﴾

31. Ne nuk kemi pasur asnjë argument për ju, përkundrazi, vetë keni qenë popull që e tepronit.

وَمَا كَانَ لَنَا عَلَيْكُمْ مِنْ سُلْطٰنٍ ۚ بَلْ كُنْتُمْ قَوْمًا طٰغِيٰنَ ﴿٣١﴾

32. Andaj, është vërtetuar mbi ne fjala e Zotit tonë! Ne gjithsesi do ta shijojmë (ndëshkimin).

فَحَقَّقْنَا عَلَيْكَ قَوْلَ رَبِّنَا ۗ إِنَّآ لَدَآبِقُونَ ﴿٣٢﴾

33. Ne ju kemi devijuar, (edhe) vetë kemi qenë të devijuar.”

فَآغْوَيْنٰكُمْ ۖ إِنَّا كُنَّا غٰوِيٰنَ ﴿٣٣﴾

34. Pra, atë ditë ata (të gjithë) do të jenë pjesëtarë në ndëshkim.

فَإِنَّهُمْ يَوْمَئِذٍ فِي الْعَذَابِ مُشْتَرِكُونَ ﴿٣٤﴾

35. Ne kështu veprojmë me fajtorët.

إِنَّا كَذٰلِكَ نَفْعَلُ بِالْمُجْرِمِيْنَ ﴿٣٥﴾

4. Fjalët “nga ana e djathtë” mund të nënkuptojnë fenë ose besimin dhe ajeti mund të ketë kuptimin: ‘Ju na keni mashtruar në emër të fesë.’ Ose ‘na erdhët duke u betuar që t’ju besonim juve’. Po kështu, fjala *jemin* (e djathtë) ka edhe kuptimin e fuqisë dhe të forcës, dhe ajeti mund të nënkuptojë: ‘Ju na erdhët me një forcë shumë të madhe.’

36. Ata ishin të atillë që kur u thuhej: “Nuk ka të adhurueshëm tjetër përveç Allahut”,<sup>5</sup> tregoheshin mendjemëdhenj.

إِنَّهُمْ كَانُوا إِذَا قِيلَ لَهُمْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ لَا  
يَسْتَكْبِرُونَ ﴿٣٦﴾

37. Dhe thoshin: “A t’i lëmë zotat tanë për një poet të çmendur?”

وَيَقُولُونَ إِنَّا لَنَرِكُورًا إِلَهَتَنَا لَشَاعِرٍ  
مَّجْنُونٍ ﴿٣٧﴾

38. Përkundrazi, ai erdhi me të vërtetën dhe i vërteton (të gjithë) të Dërguarit.

بَلْ جَاءَ بِالْحَقِّ وَصَدَقَ الْمُرْسَلِينَ ﴿٣٨﴾

39. Sigurisht, ju do ta shijoni ndëshkimin e dhimbshëm.

إِنَّكُمْ لَذَائِقُوا الْعَذَابِ الْأَلِيمِ ﴿٣٩﴾

40. Juve nuk do t’ju jepet asnjë dënim përveç asaj që keni bërë.

وَمَا تَجْزُونَ إِلَّا مَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ ﴿٤٠﴾

41. Ndryshe është për robërit e sinqertë të Allahut.

إِلَّا عِبَادَ اللَّهِ الْمُخْلِصِينَ ﴿٤١﴾

42. Këta do të kenë dhuratë të shquar;

أُولَئِكَ لَهُمْ رِزْقٌ مَّعْلُومٌ ﴿٤٢﴾

43. fruta (të ndryshme); dhe do të nderohen,

فَوَاكِهَ ۖ وَهُمْ مُكْرَمُونَ ﴿٤٣﴾

44. në kopshte plot bekime.

فِي جَنَّاتِ النَّعِيمِ ﴿٤٤﴾

45. Ballë për ballë do të jenë ulur në frone.

عَلَى سُرُرٍ مُّتَقَابِلِينَ ﴿٤٥﴾

5. Kjo pikërisht është esenca e mësimave të Kuranit, që nuk ka të adhurueshëm tjetër përveç Zotit (arab. *La ilahe il-lall-Ilah*), dhe njerëzit nuk duhet të përfshijnë asgjë dhe askënd tjetër në adhurimin dhe në dashurinë ndaj Tij. Kjo është arsyeja që muslimani është mësuar ta pohojë këtë kredo çdo herë. Fjala *ilah* rrjedh nga *velah* e arabishtes, kuptimi i së cilës është i dashuri i tillë që adhurohet. Kjo kredo është kaq e lidhur me Islamin, saqë është medalja e tij ekskluzive. Pikërisht kjo kredo këndohet me zë të lartë pesë herë në ditë në minaret e xhamive në të gjithë botën.

46. Do t'u sillen vazhdimisht kupa të mbushura prej një burimi të rrjedhshëm,

يُطَافُ عَلَيْهِمْ بِكَأْسٍ مِّن مَّعِينٍ ﴿٥٦﴾

47. të bardhë, (dhe do të jetë) kënaqësi për ata që pinë.

بِيضَاءَ لَدَدَةٍ لِّلشَّرِبِينَ ﴿٥٧﴾

48. Nga këto (pije) nuk do ketë dehje, dhe ata as nuk do të humbasin mendjen për shkak të tyre.

لَا فِيهَا عَوُولٌ وَلَا هُمْ عَنْهَا يُنرَفُونَ ﴿٥٨﴾

49. Pranë tyre do të jenë (virgjëresha) symëdha me shikim të përlulur.

وَعِنْدَهُمْ قُصِرَتِ الطَّرْفُ عِينٍ ﴿٥٩﴾

50. Sikur të jenë vezë të mbuluara.<sup>6</sup>

كَأَنَّهُنَّ بَيضٌ مَّكُونٌ ﴿٦٠﴾

51. (Robërit e sinqertë të Allahut) do të dalin përpara për të pyetur njëri-tjetrin.

فَأَقْبَلَ بَعْضُهُمْ عَلَى بَعْضٍ يَتَسَاءَلُونَ ﴿٦١﴾

52. Një folës prej tyre do të thotë: “Unë kisha një shok.

قَالَ قَائِلٌ مِّنْهُمْ إِنِّي كَانَ لِي قَرِينٌ ﴿٦٢﴾

53. (Më) thoshte: “Edhe ti je nga ata që vërtetojnë?

يَقُولُ أَأَيْتَكَ لِمَنِ الْمَصْدِقِينَ ﴿٦٣﴾

54. Kur do të vdesim dhe do të bëhemi pluhur dhe eshtra, a do të na kërkohet të japim llogari?”

إِذَا مِتْنَا وَكُنَّا تُرَابًا وَّعِظَامًا ء إِنَّا لَمَدِينُونَ ﴿٦٤﴾

55. Ai do të thotë: “A mund t'i hidhni një sy për t'u njoftuar (për të)?”

قَالَ هَلْ أُنْتُمْ مُّظْلَعُونَ ﴿٦٥﴾

56. Atëherë ai e pa atë dhe e gjeti midis xhehenemit.

فَاطَّلَعَ فَرَآهُ فِي سَوَاءِ الْجَحِيمِ ﴿٦٦﴾

57. Tha: “Për Allahun! Gati edhe mua do të më shkatërroje ti!

قَالَ تَاللَّهِ إِنْ كِدَّتْ لَتُرْدِينِ ﴿٦٧﴾

6. Ajetet 49 – 50 janë në gjuhë të figurshme, se përndryshe fjalët “vezë të mbuluara” për hyritë nuk kuptohen. Ashtu siç vezët e mbuluara janë të pastra, edhe bashkëshortet shpirtërore të robërve të Allahut do të jenë të pastra e të dëlira.

58. Sikur të mos kisha bekimin e Zotit tim, edhe unë do të isha nga ata që janë paraqitur.

وَلَوْ لَا نِعْمَةُ رَبِّي لَكُنْتُ مِنَ  
الْمُحْضَرِّينَ ﴿٥٨﴾

59. E tani, nuk do të vdekkemi më;

أَفَمَا نَحْنُ بِمَمَيِّتِينَ ﴿٥٩﴾

60. e as nuk do t'u ndëshkuakemi pas vdekjes sonë të parë!<sup>7</sup>

إِلَّا مَوْتَنَا الْأُولَىٰ وَمَا نَحْنُ بِمُعَدَّيْنَ ﴿٦٠﴾

61. Pa dyshim, kjo është fitorja madhështore.

إِنَّ هَذَا لَهُوَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ ﴿٦١﴾

62. Pikërisht për (të arritur) këtë shembull, duhet të punojnë punëmirët.

لِمِثْلِ هَذَا فَلْيَعْمَلِ الْعَامِلُونَ ﴿٦٢﴾

63. A është kjo më e mirë si pritje apo pema e *zekkumit*?!

أَذَلِكَ خَيْرٌ تُزَلُّ بِهَا شَجَرَةُ الرَّقُومِ ﴿٦٣﴾

64. Ne e kemi bërë atë si sprovë për keqbërësit.

إِنَّا جَعَلْنَا فِتْنَةً لِّلظَّالِمِينَ ﴿٦٤﴾

65. Ajo është një pemë që del nga fundi i xhehenemit.

إِنَّهَا شَجَرَةٌ تَخْرُجُ فِي أَصْلِ الْجَحِيمِ ﴿٦٥﴾

66. Frutat e saj janë sikur kokat e djajve.<sup>8</sup>

طَلْعَهَا كَأَنَّهٗ رُءُوسُ الشَّيْطَانِ ﴿٦٦﴾

7. Ky ajet përshkruan jo vetëm gëzimin e besimtarit që ai do ta shprehë në parajsë, por edhe fatin e madh për përjetësinë e tij. Ai do të kuptojë se ai pati vetëm një vdekje, të cilën e ka kaluar pas largimit të tij nga kjo botë. Pas kësaj, në udhëtimin e tij shpirtëror drejt përjetësisë nuk do të ketë më ndonjë ndalesë.

8. Për botën e *ahiretit*, Kurani i Shenjtë siç i shëmbëllen *pemët e pastra* të besimit me rrush, shegë dhe fruta të tjera të shijshme dhe tregon se atë ditë ato do t'u përngajnë këtyre frutave, në të njëjtën mënyrë, *pemën e ndyrë* të mosbesimit në botën e *ahiretit*, e quan *zekkum*, siç e thotë në këto ajete: Tregoni, cilat janë më të mira, kopshtet e xhenetit apo pema e *zekkum-it*, që është një bela për keqbërësit. Ajo është një pemë që del nga rrënja e xhehenemit, që do të thotë se lind nga arroganca dhe vetadhurimi, sepse kjo pikërisht është rrënja e xhehenemit. Fryti i saj është sikur koka e *shejtanit* (djallit). *Shejtan* do të thotë *ai që shkatërrohet* dhe kjo fjalë vjen nga një rrënjë e gjuhës arabe *she-je-ta*. Me pak fjalë, ta hash këtë frutë do të thotë të shkatërrosh vetveten.

67. Ata prej saj do të hanë dhe prej saj do ta mbushin barkun.

فَأَنَّهُمْ لَا يَكُونُونَ مِنْهَا فَمَا لِيُونُ مِنْهَا  
الْبُطُونَ ۞

68. Dhe pastaj, do të kenë edhe pije, tepër përvëluese.

ثُمَّ إِنَّ لَهُمْ عَلَيْهَا لَشَوْبًا مِّنْ حَمِيمٍ ۞

69. Më pas kthimi i tyre do të jetë xhehenemi.

ثُمَّ إِنَّ مَرْجِعَهُمْ لَإِلَى الْجَحِيمِ ۞

70. Sigurisht, ata gjetën të devijuar baballarët e tyre.

إِنَّهُمْ أَلْفَوْا آبَاءَهُمْ ضَالِّينَ ۞

71. Madje, vrapuan pas gjurmëve të tyre.

فَهُمْ عَلَىٰ أَثَرِهِمْ يُهْرَعُونَ ۞

72. Edhe shumica e të parëve para tyre kishin devijuar.

وَلَقَدْ ضَلَّ قَبْلَهُمْ أَكْثَرُ الْأُولِينَ ۞

73. Kurse Ne ua kishim dërguar (disa) alarmues.

وَلَقَدْ أَرْسَلْنَا فِيهِمْ مُّنْذِرِينَ ۞

74. Shiko pra, si u bë fundi i atyre që u paralajmëruan.

فَانظُرْ كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ الْمُنْذَرِينَ ۞

75. Ndryshe është për robërit e sinqertë të Allahut.

إِلَّا عِبَادَ اللَّهِ الْمُخْلِصِينَ ۞

76. Ne na thirri Nuhu dhe (shikoni) sa mirë që përgjigjemi Ne!

وَلَقَدْ نَادَيْنَا نُوْحًا فَلَنَعَمَ الْمُجِيبُونَ ۞

77. E shpëtuam atë dhe familjen e tij nga brenga e madhe.

وَنَجَّيْنَاهُ وَآهْلَهُ مِنَ الْكَرْبِ الْعَظِيمِ ۞

78. Dhe vetëm pasardhësit e tij i bëmë të mbijetonin.

وَجَعَلْنَا ذُرِّيَّتَهُ هُمُ الْبَاقِينَ ۞

79. Lamë kujtimin e tij tek të mëvonshmit.

وَتَرَكْنَا عَلَيْهِ فِي الْآخِرِينَ ۞

80. Paqe qoftë mbi Nuhun në të gjitha botët!

سَلِّمْ عَلَى نُوحٍ فِي الْعَالَمِينَ ﴿٨٠﴾

81. Ne kështu i shpërblejmë mirëbërësit.

إِنَّا كَذَلِكَ نَجْزِي الْمُحْسِنِينَ ﴿٨١﴾

82. Pa dyshim, ai ishte prej robërve Tanë besimtarë.

إِنَّهُ مِنْ عِبَادِنَا الْمُؤْمِنِينَ ﴿٨٢﴾

83. Më pas, të tjerët i fundosëm.

ثُمَّ أَعْرَقْنَا الْأَخْرِينَ ﴿٨٣﴾

84. Dhe, sigurisht, prej grupit të tij ishte edhe Ibrahimimi.

وَأَنَّ مِنْ شِيعَتِهِ لَإِبْرَاهِيمَ ﴿٨٤﴾

85. (Kujto kohën) kur ai erdhi te Zoti i tij me zemër të pastër.<sup>9</sup>

إِذْ جَاءَ رَبَّهُ بِقَلْبٍ سَلِيمٍ ﴿٨٥﴾

86. Kur i tha babait dhe popullit të tij: “Çfarë adhuroni ju?”

إِذْ قَالَ لِأَبِيهِ وَقَوْمِهِ مَاذَا تَعْبُدُونَ ﴿٨٦﴾

87. Duke e lënë Allahun, a doni të adhuroni gënjeshtren?

أَفِيكَآ إِلَهَةً دُونَ اللَّهِ تَرِيدُونَ ﴿٨٧﴾

88. Atëherë çfarë mendoni për Zotin e botëve?”

فَمَا ظَنُّكُمْ بِرَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿٨٨﴾

89. Pastaj, hodhi një shikim drejt yjeve.

فَنظَرَ نَظْرَةً فِي النُّجُومِ ﴿٨٩﴾

90. Dhe tha: “Jam i mërztitur.”<sup>10</sup>

فَقَالَ إِنِّي سَقِيمٌ ﴿٩٠﴾

9. Zoti ia di njeriut edhe qëllimet dhe dëshirat e tij më të fshehta. Andaj, kur të shkosh tek Ai, të duhet zemër e pastër, dhe jo hipokrizia. Të kesh zemër të pastër do të thotë të kesh paqe, të kesh bindje ndaj Tij, dashuri për Të, dhembshuri për të gjithë njerëzit e tjerë në përgjithësi, të jesh i gatshëm të thuash të vërtetën përpara njerëzve dhe t'i ndalosh ata nga gënjeshttra, të kesh urrejtje për ligësinë, të kesh respekt për njerëzit e dëlirë të Zotit, të mos jesh i shkujdesur ndaj porosive të Zotit. Ky është edhe qëllimi i fesë Islame.

10. Duket se debati i nxehtë mes *Hazret* Ibrahimit<sup>as</sup> dhe popullit të tij rreth attributeve Hyjnore u zgjat deri në orët e vona të natës, dhe duke parë se biseda nuk kishte shërbyer për përmirësimin e popullit të tij, *Hazret* Ibrahimimi donte ta ndërpriste atë. Kështu ai hodhi një vështrim te yjet, dhe tha: ‘jam i mërztitur’ ose ‘jam i lodhur’. Fjala *sekim* që vjen në këtë



91. Atëherë ata u larguan duke ia kthyer shpinën. فَتَوَلَّوْا عَنْهُ مُدْبِرِينَ ﴿١١﴾
92. Më pas, (Ibrahimi) shkoi fshehurazi te zotat e tyre dhe (i) pyeti: “A nuk hani ju? فَرَاغَ إِلَى إِلَهِتِهِمْ فَقَالَ أَلَا تَأْكُلُونَ ﴿١٢﴾
93. Çfarë keni që nuk flisni?” مَا لَكُمْ لَا تَنْطِقُونَ ﴿١٣﴾
94. Pastaj i goditi fort me të djathtën. فَرَاغَ عَلَيْهِمْ ضَرْبًا بِالْيَمِينِ ﴿١٤﴾
95. (Njerëzit) erdhën tek ai duke vrapuar. فَأَقْبَلُوا إِلَيْهِ يَزْفُونَ ﴿١٥﴾
96. Ai tha: “A i adhuroni këta që skulpturoni (vetë), قَالَ أَتَعْبُدُونَ مَا تَحْتُونَ ﴿١٦﴾
97. kurse Allahu ju ka krijuar edhe ju, edhe atë që ndërtoni ju!” وَاللَّهُ خَلَقَكُمْ وَمَا تَعْمَلُونَ ﴿١٧﴾
98. Ata thanë: “Përgatitni një pirg (zjarri) dhe hidheni këtë në zjarrin flakërues. قَالُوا ابْنُوا لَهُ بُنْيَانًا فَأَلْقُوهُ فِي الْجَحِيمِ ﴿١٨﴾
99. Pra, deshën të bënin një plan kundër tij, por Ne ata i bëmë më të poshtëruarit. فَارَادُوا بِهِ كَيْدًا فَجَعَلْنَاهُمُ الْأَسْفَلِينَ ﴿١٩﴾
100. Dhe ai tha: “Unë që po shkoj drejt Zotit Tim; Ai do të më udhëzojë. وَقَالَ إِنِّي ذَاهِبٌ إِلَىٰ رَبِّي سَيَهْدِينِ ﴿٢٠﴾
101. “O Zoti im! Më dhuro një (trashëgimtar) prej të dëlirëve!” رَبِّ هَبْ لِي مِنَ الصَّالِحِينَ ﴿٢١﴾

ajet do të thotë “i sëmure”, por këtë kuptim nuk e marrim, sepse pas kësaj *Hazret Ibrahimi*<sup>as</sup> bën një punë të fuqishme, pra thyen të gjithë idhujt e tyre, punë që një njeri i sëmure nuk e bën dot. Prandaj, kemi zgjedhur një kuptim tjetër të kësaj fjale që është “i mërziur”. Pra, *Hazret Ibrahimi*<sup>as</sup> u tha që u mërziu nga ata dhe nga idhujt e tyre. Pastaj, ai shkoi te idhujt dhe përfundimisht i theu ata.

102. Atëherë Ne i dhamë lajmin e mirë të një djali të durueshëm.

فَبَشِّرْهُ بِعَلِيمٍ حَلِيمٍ ﴿١٧﴾

103. E kur ai arriti moshën që të punonte me të, (Ibrahimi) tha: “O biri im! Shoh në gjumë që po të ther ty, mendo (edhe) ti se si e kupton!” Ai tha: “O babai im! Bëje atë që të është urdhëruar, mua do të më gjesh, në dashtë Allahu, ndër të duruarit!”<sup>11</sup>

فَلَمَّا بَلَغَ مَعَهُ السَّعْيَ قَالَ يَبِيُّ إِبْرَاهِيمَ  
أَرَى فِي الْمَنَامِ أَنِّي أَذْبَحُكَ فَانظُرْ مَاذَا  
تَرَى ۗ قَالَ يَا بَتِ افْعَلْ مَا تُؤْمَرُ سَتَجِدُنِي  
إِنْ شَاءَ اللَّهُ مِنَ الصَّابِرِينَ ﴿١٧﴾

11. Kurani dhe Bibla duket se nuk janë të një mendimi në lidhje me faktin se, në zbatim të urdhrit të Zotit, cilin nga dy djemtë e tij, Ibrahimi<sup>as</sup> (Abrahami) paraqiti për flijim, Ismailin (Ismaeli) apo Is'hakun (Isaku). Sipas Biblës, ishte Isaku (Zanafilla 22:2). Kurse Kurani i Shenjtë deklaroi qartë se ishte Ismaili. Realisht, Bibla kundërshtoi vetveten në këtë temë. Sipas saj, Zoti e urdhëroi Abrahamin të ofronte për flijim djalin e tij të vetëm (Zanafilla 22:2), por Isaku nuk ishte në asnjë moment djali i tij i vetëm. Ismaeli ishte 13 vjet më i madh se Isaku, rrjedhimisht, për shumë vite ai ishte djali i vetëm i Abrahamit. Gjithashtu, duke qenë i parëlinduri i tij, ishte dyfish i dashur për të. Edhe kjo përbën një arsye që Zoti t'i kishte kërkuar Abrahamit flijimin e njeriut më të dashur të tij, pra, të parëlindurin dhe të vetmin djalë të tij, që edhe sipas Biblës, ishte pikërisht Ismaeli. Disa evangjelistë gabojnë kur pohojnë se ‘Abrahami pati Ismaelin nga shërbëtorja dhe Isakun nga e lira; dhe se ai që lindi nga shërbëtorja lindi sipas mishit, por ai që lindi nga e lira lindi për hir të premtimit.’ (Galatasve, 4:22, 23). Përveç faktit që Agari, nëna e Ismaelit, i përkiste familjes mbretërore të Egjiptit dhe nuk ishte shërbëtoreshë, Ismaeli është përmendur vazhdimisht në Bibël si djali i Abrahamit, njësoj siç është përmendur Isaku si djali i tij (Zanafilla 16:16; 17:23, 25). Po kështu, Zoti i bëri Abrahamit premtime të ngjashme në lidhje me madhësinë e ardhshme të Ismaelit, njësoj siç i bëri për Isakun (Zanafilla 16:10. 11; 17:20). Në Bibël, përveç zëvendësimit të Isakut për Ismaelin, e që duket të jetë i qëllimshëm, dhe zëvendësimit të malit Moriah për kodrën Merva, një kodër që shtrihet në afërsi të Mekës, aty ku Abrahami la Ismaelin me nënën e tij Agarin kur ishte ende fëmijë, nuk ka asgjë për t'i dhënë mbështetjen më të vogël pikëpamjes se Abrahami të ketë ofruar Isakun për flijim dhe jo Ismailin. Përveç kësaj, në ceremonitë fetare të hebrenjve dhe të të krishterëve, nuk gjendet asnjë gjurmë e flijimit të supozuar të Isakut nga Abrahami, por nga ana tjetër, muslimanët që janë pasardhësit shpirtërorë të Ismaelit, përkujtojnë me përkushtim të madh sakrificën e Ismaelit, duke therur kurbane çdo vit në të gjithë botën, në ditën e dhjetë të muajit *dhulhixhe*. Kjo sakrificë universale e qengjave ose e bagëtive të tjera nga muslimanët vërteton pa dyshim faktin se ishte pikërisht Ismaeli që Abrahami e ofroi për flijim dhe jo Isaku. Për sa i përket ëndrrës, në fakt, *Hazret* Ibrahimit<sup>as</sup> nuk iu kërkua ta përmbushte ëndrrën e tij në kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalës. I ishte kërkuar vetëm gatishmëria për ta sakrifikuar djalin që ai e donte shumë, gjë që ai e bëri. Ëndrra simbolikisht ishte përmbushur kohë më parë kur ai i kishte lënë Haxheren (Agarin) dhe Ismailin në luginën e Mekës, e cila në atë kohë ishte një tokë e thatë dhe shterpë. Ky veprim i guximshëm i tij simbolizoi pikërisht sakrificën e Ismailit. Urdhri Hyjnor për *Hazret* Ibrahimit<sup>as</sup> në fillim për të sakrifikuar djalin e tij dhe më pas për t'u tërhequr nga kjo, në fakt, shpalli edhe shfuqizimin e flijimit të qenies njerëzore, gjë që ishte një praktikë tejet çnjerëzore, e përhapur në atë kohë midis shumë kombeve.

104. Kur të dy ranë në ujdi, dhe (Ibrahimi) e shtriu atë me ballin poshtë,

فَلَمَّا أَسْلَمَا وَتَلَّهُ لِلْجَبِينِ ۝١٠٤

105. Ne e thirrëm: O Ibrahim!

وَنَادَيْنَاهُ أَنْ يَا إِبْرَاهِيمُ ۝١٠٥

106. E ke plotësuar ëndrrën! Sigurisht, Ne kështu i shpërblejmë mirëbërësit!

قَدْ صَدَّقْتَ الرُّءْيَا ۚ إِنَّا كَذَلِكَ نَجْزِي الْمُحْسِنِينَ ۝١٠٦

107. Pa dyshim, kjo ishte sprovë e qartë!

إِنَّ هَذَا لَهُوَ الْبَلَاءُ الْمُبِينُ ۝١٠٧

108. Dhe Ne e shlyem atë me një kurban madhështor.<sup>12</sup>

وَفَدَيْنَاهُ بِذَبْحٍ عَظِيمٍ ۝١٠٨

109. Dhe e lamë kujtimin e tij tek të mëvonshmit.

وَتَرَكْنَا عَلَيْهِ فِي الْآخِرِينَ ۝١٠٩

110. Paqe qoftë mbi Ibrahimin!<sup>13</sup>

سَلَّمَ عَلَىٰ إِبْرَاهِيمَ ۝١١٠

111. Ne kështu i shpërblejmë mirëbërësit.

كَذَلِكَ نَجْزِي الْمُحْسِنِينَ ۝١١١

112. Pa dyshim, ai ishte prej robërve Tanë besimtarë.

إِنَّهُ مِنْ عِبَادِنَا الْمُؤْمِنِينَ ۝١١٢

113. Dhe atij i dhamë lajmin e mirë të Is'hakut si profet, që ishte ndër të dëlirët.

وَبَشِّرْنَاهُ بِإِسْحَاقَ نَبِيًّا مِّنَ الصَّالِحِينَ ۝١١٣

114. E bekuam atë dhe Is'hakun; prej pasardhësve të tyre kishte edhe mirëbërës, (por) edhe ata që haptazi i bënë keq vetvetes.

وَبَارَكْنَا عَلَيْهِ وَعَلَىٰ إِسْحَاقَ ۗ وَمِن ذُرِّيَّتِهِمَا مُحْسِنٌ وَظَالِمٌ لِّنَفْسِهِ مُبِينٌ ۝١١٤

12. "Kurban madhështor" ndër të tjera nënkupton edhe sakrifikuesin më të madh ndër të gjithë Profetët sakrifikues, pra *Hazret* Profetin Muhammed<sup>savs</sup>, i cili do të vinte nga shpëtimi i *Hazret* Ismailit<sup>as</sup>. Lexoni edhe parathënien e sures.

13. Çfarë dëshmie të madhe kemi sot për të vërtetuar që Zoti ka lënë një emër të mirë për *Hazret* Ibrahimin<sup>as</sup> për të mëvonshmit! Sot muslimanët, të krishterët dhe hebrejtë, pra, pasuesit e tri feve të mëdha të botës, ndihen krenarë që ia atribuojnë prejardhjen e tyre shpirtërore këtij Profeti të madh, paqja qoftë mbi të!

115. Dhe, sigurisht, Ne i bëmë mirësi Musait dhe Harunit.

وَلَقَدْ مَنَّا عَلَىٰ مُوسَىٰ وَهَارُونَ ۝١١٥

116. I shpëtuaam ata dhe popullin e tyre nga brenga e madhe.

وَنَجَّيْنَاهُمَا وَقَوْمَهُمَا مِنَ الْكَرْبِ الْعَظِيمِ ۝١١٦

117. I ndihmuam, dhe pikërisht ata u bënë triumfues.

وَنَصَّرْنَاهُمْ فَكَانُوا هُمُ الْغَالِبِينَ ۝١١٧

118. Të dyve u dhamë Librin dritëdhënës.

وَأَنزَلْنَاهُمَا الْكِتَابَ الْمُسْتَقِيمَ ۝١١٨

119. I përudhëm në rrugën e drejtë.

وَهَدَيْنَاهُمَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ ۝١١٩

120. Lamë kujtimin e tyre tek të mëvonshmit.

وَتَرَكْنَا عَلَيْهِمَا فِي الْأَخْرِينِ ۝١٢٠

121. Paqe qoftë mbi Musain dhe Harunin!

سَلَامٌ عَلَىٰ مُوسَىٰ وَهَارُونَ ۝١٢١

122. Ne kështu i shpërblejmë mirëbërësit.

إِنَّا كَذَلِكَ نَجْزِي الْمُحْسِنِينَ ۝١٢٢

123. Të dy ishin prej robërve Tanë besimtarë.

إِنَّهُمَا مِنْ عِبَادِنَا الْمُؤْمِنِينَ ۝١٢٣

124. Pa dyshim, edhe Iljasi ishte një prej të Dërguarve.<sup>14</sup>

وَإِنَّ إِلْيَاسَ لَمِنَ الْمُرْسَلِينَ ۝١٢٤

125. Kur ai i tha popullit të vet: “A nuk druheni?”

إِذْ قَالَ لِقَوْمِهِ أَلَا تَتَّقُونَ ۝١٢٥

126. A lusni Ba’lin<sup>15</sup> dhe e lini Krijuesin e përsosur,

أَتَدْعُونَ بَعْلًا وَ تَذَرُونَ أَحْسَنَ

الْخَالِقِينَ ۝١٢٦

14. *Hazret* Iljasi<sup>ra</sup> ose Elia jetoi rreth viteve 900 p.e.s.. Sipas Biblës, ai ishte një vendas i Galaadit, një vend në bregun lindor të Jordanit. Pasardhësi i tij ishte Eliseu (*Hazret* Eljesai) (Bibla, 1 i Mbretërve 17:1).

15. Ba’l ishte emri i një idhulli të popullit të Profetit Iljas<sup>ra</sup>. Këta njerëz adhuronin diellin. Ba’li gjithashtu mund të jetë edhe emri i të ashtuquajturit perëndia e diellit që i përkiste popullit të një qyteti në Siri, i cili tani quhet Baalbek. (Sot ky qytet gjendet në Liban).

127. Allahun, Zotin tuaj e Zotin e etërve tuaj të parë?”

اللَّهُ رَبُّكُمْ وَرَبُّ آبَائِكُمُ الْأُولَىٰ ﴿١٢٧﴾

128. Ata e quajtën gënjeshtar, andaj, patjetër do të paraqiten.

فَكَذَّبُوهُ فَأَتَاهُمُ الْمَحْضَرُونَ ﴿١٢٨﴾

129. Ndryshe është për robërit e sinqertë të Allahut.

إِلَّا عِبَادَ اللَّهِ الْمُخْلِصِينَ ﴿١٢٩﴾

130. Dhe lamë kujtimin e tij tek të mëvonshmit.

وَتَرَكْنَا عَلَيْهِ فِي الْآخِرِينَ ﴿١٣٠﴾

131. Paqe qoftë mbi Iljasinin!<sup>16</sup>

سَلَامٌ عَلَىٰ آلِ يَاسِينَ ﴿١٣١﴾

132. Ne kështu i shpërblejmë mirëbërësit.

إِنَّا كَذَلِكَ نَجْزِي الْمُحْسِنِينَ ﴿١٣٢﴾

133. Ai ishte prej robërve Tanë besimtarë.

إِنَّهُ مِنْ عِبَادِنَا الْمُؤْمِنِينَ ﴿١٣٣﴾

134. Pa dyshim, edhe Luti ishte (një) prej të Dërguarve.

وَإِنَّ لُوطًا لَّمِنَ الْمُرْسَلِينَ ﴿١٣٤﴾

135. Kur e shpëtuam atë dhe gjithë familjen e tij,

إِذْ نَجَّيْنَاهُ وَأَهْلَهُ أَجْمَعِينَ ﴿١٣٥﴾

136. me përjashtim të një plake, (që mbeti) mes të mbeturve.

إِلَّا عَجُوزًا فِي الْغَابِرِينَ ﴿١٣٦﴾

137. Më pas, të tjerët i shkatërruam.

ثُمَّ دَمَّرْنَا الْآخَرِينَ ﴿١٣٧﴾

138. Ju kaloni mbi (rrënojat) e tyre (edhe) në mëngjes,

وَإِنَّكُمْ لَتَمُرُّونَ عَلَيْهِمْ مُصْبِحِينَ ﴿١٣٨﴾

16. Në këtë ajet, në arabisht, në vend të thuhej “Iljas” u përdor forma “Iljasin”, (forma e shumësit që në arabisht përdoret për numrin më shumë se dy). Sipas komentuesve, një kuptim i këtij ndryshimi është se duhet të kenë qenë minimumi tre Iljasë. Por në gjuhën hebraike forma e shumësit të emrit përdoret edhe për nderim, siç gjejmë në librat e hebrejve emrin “Muhammedim” që është shumësi i emrit Muhammed<sup>sav</sup>. Ngaqë edhe Profeti Elija (Iljasi)<sup>as</sup> bëri sakrificë të jashtëzakonshme, edhe emri i tij mund të jetë përdorur në numrin shumës, një formë për ta nderuar atë.

139. edhe në darkë. A nuk kuptoni?!<sup>17</sup>

وَبِأَيِّ لُطْفٍ أَفَلَا تَعْقِلُونَ ﴿٣٧﴾

140. Dhe, sigurisht, (edhe) Junusi ishte (një) prej të Dërguarve.<sup>18</sup>

وَإِنَّ يُونُسَ لَمِنَ الْمُرْسَلِينَ ﴿٣٨﴾

141. (Kujtoni) kur ai u arratis drejt anijes së mbushur.

إِذْ أَبَقَ إِلَى الْفُلِّ الْمُسْحُونِ ﴿٣٩﴾

142. Zgjodhi shortin dhe (shorti) doli që atë ta hidhnin (jashtë anijes).

فَسَاهَمَ فَكَانَ مِنَ الْمُدْحَضِينَ ﴿٤٠﴾

143. Dhe atë e gëlltiti peshku, ndërkohë që e qortonte (veten).

فَالْتَقَمَهُ الْحُوتُ وَهُوَ مُلِيمٌ ﴿٤١﴾

144. Po të mos ishte nga ata që përkujtojnë shenjtërinë e Zotit,

فَلَوْلَا أَنَّهُ كَانَ مِنَ الْمُسَبِّحِينَ ﴿٤٢﴾

145. do të mbetej në barkun e tij deri në ditën kur ringjallen (njerëzit).

لَلَيْتَ فِي بَطْنِهِ إِلَى يَوْمِ يُبْعَثُونَ ﴿٤٣﴾

146. Atëherë Ne e gjuajtëm në një fushë, ndërkohë që ishte i sëmurë.

فَنَبَذْنَاهُ بِالْعَرَاءِ وَهُوَ سَقِيمٌ ﴿٤٤﴾

147. Dhe bëmë të mbinte sipër tij një bimë kungulli.

وَأَنْبَتْنَا عَلَيْهِ شَجَرَةً مِّنْ يَقْطِينٍ ﴿٤٥﴾

148. Pas kësaj, atë e dërguam te njëqind mijë (njerëz), madje ata po shtoheshin.

وَأَرْسَلْنَاهُ إِلَى مِائَةِ أَلْفٍ أَوْ يَزِيدُونَ ﴿٤٦﴾

149. Ata (e) besuan dhe Ne i bëmë të përfitonin deri në një kohë të caktuar.

فَأَمِنُوا فَمَتَّعْنَاهُمْ إِلَىٰ حِينٍ ﴿٤٧﴾

17. Sodoma dhe Gomorra janë qytete në të cilat Profeti Lut<sup>as</sup> predikoi Mesazhin e tij, dhe që ndodheshin në rrugën kryesore që kalonte nga Arabia në Siri, ku karvanët arabë kalonin ditë e natë. Në një ajet tjetër në Kuran, këto qytete përmenden si të vendosura ‘në një rrugë që ekziston ende’ (15:77).

18. Sipas Biblës, Profeti Junus<sup>as</sup> ishte një profet izraelit dhe jetoi në shekullin e 9-të p.e.s. në mbretërinë e Jeroboamit II ose të Jehoahazit.

150. Pyeti (mohuesit),<sup>19</sup> për Zotin tënd paska vajza, kurse për ta djem?!<sup>20</sup>

فَأَسْتَفْتِهِمْ أَلِرَبِّكَ الْبَنَاتُ وَلَهُمُ الْبُنُونَ ﴿٢٠﴾

151. Apo paskemi krijuar engjëjt si femra dhe ata paskëshin qenë dëshmitarë (atëherë)?!

أَمْ خَلَقْنَا الْمَلَائِكَةَ إِنَاثًا وَهُمْ شَاهِدُونَ ﴿٢١﴾

152. Përkundrazi, po thonë duke trilluar vetëm nga ana e tyre;

أَلَا إِنَّهُمْ مِّنْ أَفْكَهٍ يُقُولُونَ ﴿٢٢﴾

153. (që) “Allahu ka lindur djalë”, dhe sigurisht që ata janë gënjeshtarë.

وَلَدَ اللَّهُ ۗ وَإِنَّهُمْ لَكَاذِبُونَ ﴿٢٣﴾

154. Vallë, u paska dhënë përparësi Ai vajzave mbi djemtë?!

أَصْطَفَى الْبَنَاتِ عَلَى الْبَنِينَ ﴿٢٤﴾

155. Çfarë keni?! Si gjykoni në këtë mënyrë?!

مَا لَكُمْ ۖ كَيْفَ تَحْكُمُونَ ﴿٢٥﴾

156. A nuk mendoheni?!

أَفَلَا تَذَكَّرُونَ ﴿٢٦﴾

157. Apo keni ndonjë argument të qartë?!

أَمْ لَكُمْ سُلْطٰنٌ مُّبِينٌ ﴿٢٧﴾

158. Atëherë sillni librin tuaj, nëse jeni të vërtetë!

فَأْتُوا بِكِتَابِكُمْ إِن كُنْتُمْ صَادِقِينَ ﴿٢٨﴾

159. Dhe ata bënë lidhje gjaku mes Tij dhe mes xhindëve. Kurse xhindët e dinë se do të paraqiten patjetër.

وَجَعَلُوا بَيْنَهُ وَبَيْنَ الْجِنَّةِ نَسَبًا ۗ وَلَقَدْ

عَلِمَتِ الْجِنَّةُ إِنَّهُمْ لَمُحْضَرُونَ ﴿٢٩﴾

160. I pastër është Allahu nga ajo që ata përshkruajnë.

سُبْحٰنَ اللَّهِ عَمَّا يُصِفُونَ ﴿٣٠﴾

161. Ndryshe është për robërit e sinqertë të Allahut.

إِلَّا عِبَادَ اللَّهِ الْمُخْلِصِينَ ﴿٣١﴾

19. Mohuesit mekas.

20. Fuqitë Hyjnore arabët ua atribuonin engjëjve, duke besuar se ato ishin bijat e Zotit, *ma'adhallah*. Është kjo formë e idhujtarisë që është dënuar në këto ajete.

162. Pra, ju dhe ata (idhuj) që adhuroni,

فَأَنْتُمْ وَمَا تَعْبُدُونَ ﴿١٦٢﴾

163. nuk mund të ngatërroni dot (dikë) rreth Tij,

مَا أَنْتُمْ عَلَيْهِ بِفِتْنِينَ ﴿١٦٣﴾

164. përveç atij që është për t'u hedhur në xhehenem.

إِلَّا مَنْ هُوَ صَالِ الْجَحِيمِ ﴿١٦٤﴾

165. (Engjëjt do të thonë): “Gjithsecili prej nesh ka një pozitë të caktuar.

وَمَا مِمَّا إِلَّا لَهُ مَقَامٌ مَّعْلُومٌ ﴿١٦٥﴾

166. Dhe, pa dyshim, jemi të rreshtuar.

وَإِنَّا لَنَحْنُ الصَّافُونَ ﴿١٦٦﴾

167. Ne përkujtojmë shenjtërinë e Allahut.”

وَإِنَّا لَنَحْنُ الْمُسَبِّحُونَ ﴿١٦٧﴾

168. Ndërsa (mohuesit) thonë:

وَإِنْ كَانُوا لَيَقُولُونَ ﴿١٦٨﴾

169. Po të kishim ndonjë këshillë të të parëve,

لَوْ أَنَّ عِنْدَنَا ذِكْرًا مِنَ الْأُولِيَّينَ ﴿١٦٩﴾

170. patjetër do të bëheshim robër të sinqertë të Allahut.

لَكِنَّا عِبَادَ اللَّهِ الْمُخْلِصِينَ ﴿١٧٠﴾

171. E (tani që) ata e mohuan (Allahun), së shpejti do të mësojnë (përfundimin).

فَكَفَرُوا بِهِ فَسَوْفَ يَعْلَمُونَ ﴿١٧١﴾

172. Sigurisht, ka kaluar dekreti Ynë për robërit Tanë të dërguar;

وَلَقَدْ سَبَقَتْ كَلِمَتُنَا لِعِبَادِنَا الْمُرْسَلِينَ ﴿١٧٢﴾

173. (që) pikërisht ata do të ndihmohen.

إِنَّهُمْ لَهُمُ الْمَنْصُورُونَ ﴿١٧٣﴾

174. Dhe pikërisht ushtria Jonë do të jetë Triumfuese.

وَإِنْ جُنَدَنَا لَهُمُ الْغَالِبُونَ ﴿١٧٤﴾



175. Andaj, shmangu prej tyre deri në një kohë.

فَتَوَلَّ عَنْهُمْ حَتَّىٰ حِينٍ ﴿١٧٥﴾

176. Dhe shikoji ata, edhe ata së shpejti do të shikojnë.

وَ أَبْصَرَهُمْ فَسَوْفَ يُبْصِرُونَ ﴿١٧٦﴾

177. A po kërkojnë ndëshkimin Tonë që të vijë shpejt?!

أَفِعْدَابًا يَسْتَعْجِلُونَ ﴿١٧٧﴾

178. E kur ai do t'u zbresë në oborr! Sa i keq do të jetë mëngjesi i të paralajmëruarve.

فَإِذَا نَزَلَ بِسَاحَتِهِمْ فَسَاءَ صَبَاحُ الْمُنذَرِينَ ﴿١٧٨﴾

179. Shmangu prej tyre deri në një kohë,

وَتَوَلَّ عَنْهُمْ حَتَّىٰ حِينٍ ﴿١٧٩﴾

180. Dhe (vetëm) shiko, edhe ata së shpejti do të shikojnë.

وَ أَبْصَرُ فَسَوْفَ يُبْصِرُونَ ﴿١٨٠﴾

181. I pastër është Zoti yt, Zoti i nderit, nga ajo që ata përshkruajnë.

سُبْحٰنَ رَبِّكَ رَبِّ الْعِزَّةِ عَمَّا يَصِفُونَ ﴿١٨١﴾

182. Paqe qoftë mbi të Dërguarit!

وَسَلَّمَ عَلَى الْمُرْسَلِينَ ﴿١٨٢﴾

183. Dhe lavdia është e Allahut, Zotit të botëve.

عِذِّ وَالْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿١٨٣﴾

## Surja 38 – Sad

Surja Sad është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka tetëdhjetë e nëntë ajete.

Edhe kjo sure fillon me një shkurtisë, me shkronjën “Sad”, për të cilën komentues të ndryshëm pohojnë se ajo nënkupton “*Sadikul-kaul*”, pra, Allahu është i Vërteti në fjalë. Gjithashtu, Kurani që përbëhet nga këshilla madhore, u soll si dëshmitar për të pohuar se mohuesit e kundërshtojnë vetëm për shkak të nderit të tyre të rremë.

Kjo sure paraqet një *keshf* të *Hazret Davudit*<sup>as</sup>, *keshf* që tregon lakminë e njeriut, të cilit edhe po t’i jepej pushteti nëntëdhjetë e nëntë për qind, prapëseprapë ai do të lakmojë ta ketë njëqind për qind, duke mos lëshuar asnjë grimë të pushtetit për njeriun tjetër të dobët. Në fillim të sures paraardhëse u paraqit një pamje e luftërave të fuqive të mëdha. Edhe ato synojnë t’u rrëmbejnë vendeve të varfra çdolloj pushteti, në mënyrë që vetë të bëhen sundues pa ortak në të gjithë botën. Me fjalë të tjera, synojnë të bëhen Zot. Pas kësaj, duke iu referuar *Hazret Davudit*<sup>as</sup>, kjo sure e këshillon njerëzimin që mosmarrëveshjet t’i zgjidhin me drejtësi, e jo me padrejtësi e dhunë.

Po kjo sure tregon dashurinë e madhe që ka pasur *Hazret Sulejmani*<sup>as</sup> për kuajt. Duke e keqinterpretuar ajetin në fjalë, disa *dijetarë* tregojnë se një herë tek po i ledhatonte kuajt në këmbët dhe qafat e tyre, *Hazret Sulejmani*<sup>as</sup> nuk iu kujtua që paska kaluar koha e namazit. Sipas tyre, harresa e *Hazret Sulejmani*<sup>as</sup> e zemëroi kaq shumë vetë atë, sa që urdhëroi që të vriteshin kuajt e pafajshëm. Kurani i Shenjtë e hedh poshtë këtë komentim qesharak në ajetin vijues, i cili pohon se *Hazret Sulejmani*<sup>as</sup> porositi që t’i shikonte kuajt edhe një herë. Në fakt, ky ajet tregon se Profetët e Allahut i duan shumë mjetet e udhëtimit që Allahu ua jep për të bërë xhihad në rrugën e Tij, dhe kërkojnë vazhdimisht t’i shohin ato. Edhe Profeti Muhammed<sup>savs</sup> tha: Për *umetin* tim deri në Ditën e Kiametit balli i atyre kuajve është bërë i bekuar, të cilët përgatiten për të bërë xhihad në rrugën e Allahut. (Sahih Buhari, kitab: “El-Xhihad ves-sijer”, hadithi nr. 2849) [Për më shumë rreth temës së xhihadit, lexoni 25:53].

Kjo sure paraqet edhe shembullin e *Hazret Ejubit*<sup>as</sup> si një Profet që kishte durim të jashtëzakonshëm dhe gjithashtu tregon të vërtetat, të cilat në Bibël i gjejmë në formë tregimesh të çuditshme.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. *Sad*. (I vërteti në fjalë.) Betothem për Kuranin (që) përmban këshillë!<sup>1</sup>

ص وَالْقُرْآنِ ذِي الذِّكْرِ ①

3. Por ata që mohuan, në të vërtetë janë (të zhytur) në nder (të rremë) dhe armiqësi.

بَلِ الَّذِينَ كَفَرُوا فِي عِزَّةٍ وَشِقَاقٍ ①

4. Sa shumë popuj para tyre i kemi shkatërruar! Ata thirrën (për ndihmë), por atëherë më nuk kishte asnjë rrugëdalje.

كَمْ أَهْلَكْنَا مِنْ قَبْلِهِمْ مِنْ قَرْنٍ فَنَادَوا  
وَلَاتَ حِينَ مَنَاصٍ ①

5. Ata u çuditën pse u erdhi një alarmues prej tyre, dhe mohuesit thanë: “Ky është magjistar (dhe) gënjeshtar i madh!

وَعَجِبُوا أَنْ جَاءَهُمْ مُنْذِرٌ مِنْهُمْ وَقَالَ  
الْكَافِرُونَ هَذَا سِحْرٌ كَذَّابٌ ①

6. A i ka kthyer zotat në një zot të vetëm? Kjo qenka një gjë tepër e çuditshme!”

أَجَعَلَ الْأِلَهَةَ إِلَهًا وَاحِدًا ۗ إِنَّ هَذَا لَشَيْءٌ عُجَابٌ ①

7. Prijësit e tyre ikën (duke thënë): “Shkoni dhe duroni me zotat tuaj; kjo është diçka që synohet (për qëllime të caktuara).<sup>2</sup>

وَأَنْطَلَقَ الْمَلَأُ مِنْهُمْ أَنْ آمَسُوا  
وَأَصْبِرُوا عَلَىٰ آلِهَتِكُمْ ۗ إِنَّ هَذَا لَشَيْءٌ  
يُرَادُ ①

1. Fjala “*dhikr*” që është përkthyer si këshillë, ka disa kuptime: përmendje, këshillë, kujtesë, ligjërim, përkujtim etj., dhe duke iu referuar emrit, pra Kuranit, mund të aplikohen edhe kuptime të tjera të lartpërmendura. Po kështu, “*dhikr*” në këtë ajet nënkupton atë që ta zgjon kujtesën që e ke të gdhendur në shpirtin tënd. Pra, Kurani ka ardhur për t’ia zgjuar njeriut gjërat që ai ka harruar. Parimet që parashtron Kurani përputhen me shpirtin e pastër njerëzor. Kurse doktrina të tjera si idhujtaria etj., nuk janë pjesë të natyrshme të shpirtit të njeriut.

2. Njerëzit me zemra të errëta pikërisht kështu i kanë paragjykuar Profetët e Zotit që nga lashtësia. Faraoni e paragjykoi *Hazret Musain*<sup>as</sup>, dhe duke iu drejtuar njerëzve të vet tha – Ky

8. Nuk e kemi dëgjuar këtë as në popullin e mëparshëm; kjo qenka vetëm një sajese!

مَا سَمِعْنَا بِهَذَا فِي الْمَلَّةِ الْأَخْرَةَ ۖ إِنَّ هَذَا إِلَّا اخْتِلَافٌ ۝

9. Pse, vetëm atij i paska zbritur këshilla mes nesh?!” E vërteta është që ata kanë dyshime për këshillën Time, madje e vërteta është që ata ende nuk kanë shijuar ndëshkimin Tim.

ءَأَنْزَلَ عَلَيْهِ الذِّكْرُ مِنْ بَيْنِنَا ۗ بَلْ هُمْ فِي شَكٍّ ۖ مِنْ ذِكْرِي ۗ بَلْ لَمَّا يَدُوُّوْا عَذَابٍ ۝

10. A kanë me vete thesaret e mëshirës së Zotit tënd Mbizotërues (dhe) Dhurues të madh?!

أَمْ عِنْدَهُمْ خَزَائِنُ رَحْمَةِ رَبِّكَ الْعَزِيزِ الْوَهَّابِ ۝

11. Apo kanë pushtetin e qiejve, të tokës dhe të asaj që gjendet midis tyre?! Atëherë, le të ngjiten me litar (në qiell).

أَمْ لَهُمْ مُلْكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا ۗ فَلْيَرْتَقُوا فِي الْأَسْبَابِ ۝

12. Edhe kjo është një ushtri e vogël, prej (atyre) grupeve që do të munden atje.<sup>3</sup>

جُنُودًا مَّا هُنَالِكَ مَهْرُومٍ مِنَ الْأَحْرَابِ ۝

13. Edhe para tyre mohuan populli i Nuhut, adët dhe Faraoni i gozhdëve.<sup>4</sup>

كَذَّبَتْ قَبْلَهُمْ قَوْمُ نُوحٍ وَعَادٌ وَفِرْعَوْنُ ذُو الْأَوْتَادِ ۝

në të vërtetë do që t’ju dëbojë nga vendi juaj dhe të sundojë këtu pas jush. Kështu e paragjykan hebrenjtë *Hazret Isain*<sup>as</sup> dhe thanë – Është mashtrues dhe me petkun e profetërisë do që të na sundojë ne. Kështu e paragjykan mohuesit mekas edhe Profetin tonë<sup>savs</sup> duke thënë – Ky po e bën këtë për qëllime vetjake. Prandaj, kërkuesi i së vërtetës duhet të ketë shprehur që ta dëgjojë me vëmendje deklaratën, t’i studiojë me drejtësi argumentet dhe më pas të japë fjalën e tij duke pasur frikë ndaj Zotit, duke punuar me drejtësi dhe logjikë.

3. Ajeti përmban një profeci, njëherësh edhe sfidë për forcat e së keqes. Sfidat është që ato të grumbullojnë të gjitha burimet e tyre, të formojnë një aleancë të fortë për të ndaluar përhapjen e Islamit. Dhe profecia është se aleanca e bashkuar e mohuesve do të shkatërrohet me poshtërsi të madhe. Kjo profeci e fuqishme u përmbush fjalë për fjalë në Betejën e Hendekut.

4. *Dhul-eutad* (i gozhdëve): *eutadul-erd* do të thotë male; dhe *eutadul-bilad* nënkupton prijësit e qyteteve; dhe *dhul-eutad* nënkupton zotërues të ushtrive ose të kunjave a të gozhdëve të mëdha (Fjalori “Akrabul-Mevärid”).

14. Edhe themudët, populli i Lutit dhe njerëzit e pyllit. Këto janë grupet (që thamë më lart).

وَتَمُودُ وَقَوْمُ لُوطٍ وَ أَصْحَابِ نِيَّكَةَ ط  
أُولَئِكَ الْأَحْرَابُ ①

15. Secili (prej tyre) i quajten gënjeshtarë të Dërguarit, andaj, u meritua dënimi Im (për ta).

لِيُجْزَىٰ إِنْ كُنَّ إِلَّا كَذَّبَ الرَّسُلَ فَحَقَّ عِقَابِ ②

16. Dhe këta nuk presin asgjë tjetër përveç një gjëmimi të vetëm, i cili nuk do të pushojë.

وَمَا يَنْظُرُ هَؤُلَاءِ إِلَّا صَيْحَةً وَاحِدَةً  
مَّا هِيَ مِنْ فَوَاقِي ③

17. Dhe thanë: “O Zoti ynë! Jepna shpejt pjesën tonë, përpara ditës së llogarisë!”

وَقَالُوا رَبَّنَا عَجِّلْ لَنَا قِطْنَآ قَبْلَ يَوْمِ  
الْحِسَابِ ④

18. Duro atë që ata thonë dhe kujto robin Tonë, Davudin duarfuqishëm. Pa dyshim, ai ishte shumë i përrulur.<sup>5</sup>

إِصْرٍ عَلَىٰ مَا يَقُولُونَ وَإِذْ كُرَّ عَبْدَنَا دَاوُدَ  
ذَا الْأَيْدِيَّ إِنَّهُ أَوَّابٌ ⑤

19. Për të Ne nënshtroam malet, (që) madhëronin Allahun mbrëmjeve e mëngjesëve;

إِنَّا سَخَّرْنَا الْجِبَالَ مَعَهُ يُسَبِّحْنَ بِالْعَشِيِّ  
وَالْإِشْرَاقِ ⑥

20. edhe zogjtë e grumbulluar (i nënshtroam për të). Të gjithë Atij (pra, Zotit) i përuleshin.

وَالطَّيْرَ مَحْشُورَةً كُلٌّ لَهُ أَوَّابٌ ⑦

21. Ia forcua mbretërinë, i dhamë urtësinë dhe ligjërimin vendimtar.

وَشَدَدْنَا مُلْكَهُ وَأَتَيْنَهُ الْحِكْمَةَ وَفَصَّلَ  
الْخِطَابِ ⑧

22. A të erdhi lajmi për ata që grindeshin; kur ata kapërcyen gardhin (dhe) u futën në dhomë?

وَهَلْ أَتَاكَ نَبَأُ الْخَضِرِ ۗ إِذْ تَسَوَّرُوا  
الْمِحْرَابَ ⑨

5. Profetët Davudi, Sulejmani dhe Ejubi paqja qoftë mbi ta, kanë pasur ndikim dhe pasuri të madhe. Ndoshta kjo është një arsye që në shumë vende në Kuran, ata janë përmendur bashkë (4:164; 6:85; 21:80-84).

23. Kur ata erdhën përpara Davudit, ai u frikësua prej tyre. Thanë: “Mos u tremb. Jemi dy (palë) që grindemi; njëri e dhunoi tjetrin. Prandaj, vendos mes nesh me drejtësi, mos bëj mizori dhe na udhëzo në rrugën e drejtë.”

24. “Ky është vëllai im që ka nëntëdhjetë e nëntë dele e unë kam një dele, prapëseprapë ky thotë: ‘Ma dorëzo edhe atë!’, dhe më mund duke folur.”

25. (Davudi) tha: Pa dyshim, ai të bëri padrejtësi duke të kërkuar delen tënde për ta bashkuar me delet e tij. Dhe shumica e ortakëve nëpërkëmbin njëri-tjetrin, përveç atyre që besuan dhe bënë të mira dhe shumë pak janë të tillë. Davudi e kuptoi se Ne e kemi sprovuar, atëherë ai i kërkoi falje Zotit të tij, ra duke u përlulur dhe u pendua.<sup>6</sup>

Sexhdeja XI

26. Ne ia falëm këtë (gabim) dhe, sigurisht, pranë Nesh ai ka një pozitë të afërt dhe vendkthim të bukur.

27. O Davud! Ne të bëmë kalif (pra, mëkëmbës) në tokë, andaj, gjyko mes njerëzve me drejtësi dhe mos ndiq dëshirën (vetjake), se ajo të largon nga rruga e Allahut. Pa dyshim, ata që largohen nga rruga e Allahut do të kenë ndëshkim të rëndë, për shkak se harruan Ditën e Gjykimit.

إِذْ دَخَلُوا عَلَىٰ دَاوُدَ فَفَزِعَ مِنْهُمْ قَالُوا  
لَا تَخَفْ ۗ خَصَمِينَ بَعْضًا عَلَىٰ بَعْضٍ  
فَاحْكُم بَيْنَنَا بِالْحَقِّ وَلَا تُسْطِظْ وَاهِدَنَا  
إِلَىٰ سَوَاءِ الصِّرَاطِ ۝١٧

إِنَّ هَذَا أَخِي ۖ لَهُ تِسْعٌ وَتِسْعُونَ نَعَجَةً  
وَلِي نَعَجَةٌ وَاحِدَةٌ ۖ فَقَالَ أَكْفِلْنِيهَا  
وَعَزَّزْنِي فِي الْخِطَابِ ۝١٨

قَالَ لَقَدْ ظَلَمَكَ بِسُؤَالِ نَعَجِكَ إِلَىٰ  
نِعَاجِهِ ۗ وَإِنَّ كَثِيرًا مِّنَ الْخُلَطَاءِ لِيَبْغِي  
بَعْضُهُمْ عَلَىٰ بَعْضٍ إِلَّا الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا  
الصَّالِحَاتِ وَقَلِيلٌ مَّا هُمْ ۗ وَظَنَّ دَاوُدُ أَنَّمَا  
فَتَنَتْهُ فَاستَغْفَرَ رَبَّهُ وَخَرَّ رَاكِعًا  
وَأَنَابَ ۝١٩

فَغَفَرْنَا لَهُ ذَٰلِكَ ۗ وَإِنَّ لَهُ عِندَنَا لَزُلْفَىٰ  
وَحُسْنَ مَّآبٍ ۝٢٠

يَا دَاوُدُ إِنَّا جَعَلْنَاكَ خَلِيفَةً فِي الْأَرْضِ  
فَاحْكُم بَيْنَ النَّاسِ بِالْحَقِّ وَلَا تَتَّبِعِ  
الْهَوَىٰ فَيُضِلَّكَ عَن سَبِيلِ اللَّهِ ۗ إِنَّ الَّذِينَ  
يَضِلُّونَ عَن سَبِيلِ اللَّهِ لَهُمْ عَذَابٌ شَدِيدٌ  
بِمَا نَسُوا يَوْمَ الْحِسَابِ ۝٢١

6. Lexoni në parathënien e kësaj sureje një shpjegim të këtij ajeti.

28. Ne nuk e kemi krijuar pa qëllim qiellin, tokën dhe atë që është mes tyre. Kjo është hamendja e atyre që mohuan. U shkatërrofshin prej zjarrit ata që mohuan!

وَمَا خَلَقْنَا السَّمَاءَ وَالْأَرْضَ وَمَا بَيْنَهُمَا  
بَاطِلًا ۗ ذَٰلِكَ ظَنُّ الَّذِينَ كَفَرُوا ۗ فَوَيْلٌ  
لِّلَّذِينَ كَفَرُوا مِنَ النَّارِ ۗ

29. A do t'i trajtojmë ata që besuan dhe bënë të mira, sikur ngatërrestarët në tokë?! A do t'i trajtojmë ata që kanë druajtje (ndaj Zotit) sikur të pamoralshmit?!

أَمْ نَجْعَلُ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ  
كَالْمُفْسِدِينَ فِي الْأَرْضِ ۗ أَمْ نَجْعَلُ  
الْمُتَّقِينَ كَالْفُجَّارِ ۗ

30. (Ky) Libër (i madhërishëm) që të kemi zbritur ty është i bekuar, që këta të thellohen në ajetet e tij dhe që mendarët të këshillohen.

كِتَابٌ أَنْزَلْنَاهُ إِلَيْكَ مُبَارَكٌ لِّيَدَّبَّرُوا  
آيَاتِهِ وَلِيَتَذَكَّرَ أُولُو الْأَلْبَابِ ۗ

31. Dhe Davudit i dhuruam Sulejmanin. Sa rob i mirë që ishte ai! Ishte shumë i përlulur.

وَوَهَبْنَا لِدَاوُدَ سُلَيْمَانَ ۗ نِعَمَ الْعَبْدِ  
إِنَّهُ أَوَّابٌ ۗ

32. (Kujto) kur atij i sollën në mbrëmje kuajt e shkathët,

إِذْ عَرَضَ عَلَيْهِ بِالْعَشيِّ الضَّفِيرَةُ الْجِيَادُ ۗ

33. ai, gjersa (kuajt) iu tretën para syve, tha: “Sigurisht, dashurinë për pasuri e kam për shkak të kujtimit të Zotit tim”.

فَقَالَ إِنِّي أَحْبَبْتُ حُبَّ الْخَيْرِ عَنْ ذِكْرِ  
رَبِّي ۗ حَتَّى تَوَارَتْ بِالْحِجَابِ ۗ

34. (Sulejmani tha:) “M’i ktheni prapë!,” dhe (më pas) ai vijoi t’i përkëdhelte te këmbët dhe qafat.<sup>7</sup>

رُدُّوَهَا عَلَيَّ ۗ فَنَطْفِقُ مَسْحًا بِالسُّوقِ  
وَالْأَعْنَاقِ ۗ

7. Për ajetet 32 – 34, komentuesit në përgjithësi mendojnë se *Hazret Sulejmani*<sup>as</sup> e donte kaq shumë tufën e kuajve të tij, sa që një ditë, duke i soditur kuajt, harroi kohën e faljes (pra, të namazit). Dhe duke u zemëruar nga kjo, sipas tyre, ua preu kuajve këmbët dhe qafat. Por ky komentim është i padenjë dhe fyerje ndaj Kuranit të Shenjtë. Nëse i iku koha e namazit, së pari duhej përmendur se kur e plotësoi namazin e pafalur. Gjithashtu, soditjen e kuajve ai po e bënte me dëshirën e vet, atëherë çfarë faji kishin kuajt e shkretë që ata të dënoheshin kaq barbarisht?! Në të vërtetë, kjo ushtri kuajsh ishte caktuar për xhihadin në rrugë të Allahut, andaj, *Hazret Sulejmani*<sup>as</sup> i donte shumë dhe ua përkëdheli këmbët dhe qafat, siç bën edhe sot

35. Ne e sprovuam Sulejmanin dhe mbi karrigen e tij (mbretërore), hodhëm një trup (të pamend e të pashpirt), më pas (Sulejmani te Zoti i tij) anoi,<sup>8</sup>

وَلَقَدْ فَتَنَّا سُلَيْمَانَ وَأَلْقَيْنَا عَلَى كُرْسِيِّهِ  
جَسَدًا ثُمَّ أَنَابَ ﴿٥٠﴾

36. (dhe) tha: “O Zoti im! Më fal mua dhe më dhuro mbretërinë, e cila të mos i përshtatet askujt pas meje! Pa dyshim, Ti je Dhuruesi i madh!”<sup>9</sup>

قَالَ رَبِّ اغْفِرْ لِي وَهَبْ لِي مُلْكًا  
لَا يَتَّبِعُنِي لِأَحَدٍ مِّنْ بَعْدِي إِنَّكَ  
أَنْتَ الْوَهَّابُ ﴿٥١﴾

37. Ne nënshtruam për të erën që me urdhrin e tij frynte ngadalshëm ngado që ai dëshironte ta çonte.

فَسَخَّرْنَا لَهُ الرِّيحَ تَجْرِي بِأَمْرِهِ رُحَاءً  
حَيْثُ أَصَابَ ﴿٥٢﴾

38. (Po kështu, nënshtruam për të) edhe djajtë, (pra), çdo mjeshtër ndërtues e zhytës.

وَالشَّيْطِينَ كُلَّ بَنَّاءٍ وَعَوَّاصٍ ﴿٥٣﴾

39. Dhe (nënshtruam edhe) të tjerë, të cilët ishin vënë në pranga.<sup>10</sup>

وَآخَرِينَ مُقَرَّنِينَ فِي الْأَصْفَادِ ﴿٥٤﴾

dikush që i pëlqen kuajt. Dhe *Hazret Sulejmani*<sup>as</sup> edhe këtë dashuri, siç e pohon ajeti, e kishte për shkak të dashurisë ndaj Allahut.

8. Kuptimi i këtij ajeti është që trashëgimtari i *Hazret Sulejmanit*<sup>as</sup> nuk kishte as aftësi shpirtërore e as drejtuese për mbretërinë e tij, dhe ishte thjesht një trup i pashpirt. Fjalët “hodhëm mbi karrigen e tij” nënkuptojnë ardhjen e të birit në fronin mbretëror. Komentues të ndryshëm kanë bërë padrejtësi edhe ndaj këtij ajeti, deri atje sa që e quajtën *Hazret Sulejmanin*<sup>as</sup> njeri të pabindur ndaj Zotit. Sipas tyre një femër e bukur që nuk qe gruaja e tij u ul në fron dhe ai deshi të bënte veprim të pamoralshëm, ndërkohë iu kujtua se kjo paska qenë një sprovë prej Allahut. Kjo është përrallë, njësoj si ajo që disa komentues kanë bërë edhe me *Hazret Jusufin*<sup>as</sup>. Lexoni edhe 34:15.

9. Ky ajete tregon përfundimin e asaj që u tha në ajetet e mëparshme. Kur *Hazret Sulejmani*<sup>as</sup> kuptoi që djali i tij nuk ka as spiritualizëm dhe as aftësi drejtuese, ai vetë iu lut Zotit që një mbretëri kaq të madhe Zoti të mos ia jepte tjetërkuajt. Edhe historia dëshmon se pas *Hazret Sulejmanit*<sup>as</sup>, mbretëria e tij filloi të binte.

10. Profeti Sulejman<sup>as</sup>, siç thuhet edhe në 21:83 dhe 34:13-14, arriti të nënshtronte fiset rebele malësore që ato t'i shërbenin perandorisë së tij. Ai ua ngarkoi punët më të rënda në mbretërinë e tij. Djajtë në ajetin e mëparshëm dhe xhindët e 34:13, janë të njëjtët njerëz dhe puna për të cilën ata u ngarkuan nga *Hazret Sulejmani*<sup>as</sup>, gjithashtu ishte njëloj (2 i Kronikave 2:1-2).



40. “Kjo është dhurata Jonë e pallogaritshme, andaj, bëj mirësi (me anë të saj) ose mbaje.”

هَذَا عَطَاؤُنَا فَامْنُنْ أَوْ أَمْسِكْ بِغَيْرِ  
حِسَابٍ ٤٠

41. Dhe, sigurisht, pranë Nesh ai ka një pozitë të afërt dhe vendkthim të bukur.

وَإِنَّ لَهُ عِنْدَنَا لَزُلْفَىٰ وَحَسَنَ مَّآبٍ ٤١

42. Kujto robin Tonë, Ejubin. Kur ai e thirri Zotin e tij: “Djali më ka zënë me brengë e ndëshkim!”

وَاذْكُرْ عَبْدَنَا أَيُّوبَ ۖ إِذْ نَادَىٰ رَبَّهُ أَنِّي  
مَسْنِيَّ الشَّيْطَانِ يَنْصُبْ عَلَيَّ وِعْدَابٍ ٤٢

43. (Ne i thamë): Bjeri me këmbë (kafshës sate)! Këtu (afër) është një burim i freskët për t’u larë e për të pirë.

أَرْكُضْ بِرِجْلِكَ ۗ هَذَا مُغْتَسَلٌ بَارِدٌ  
وَشَرَابٌ ٤٣

44. Dhe i dhuruam familjen dhe edhe të tjerë si ata, si mëshirë prej Nesh dhe si mësim për të mençurit.<sup>11</sup>

وَوَهَبْنَا لَهُ أَهْلَهُ وَمِثْلَهُم مَّعَهُمْ رَحْمَةً  
مِّنَّا وَذِكْرًا لِأُولِي الْأَلْبَابِ ٤٤

45. (I thamë:) “Merr në dorë ca fije kashtë, godite me to dhe mos e thyej betimin (tënd)!” Pa dyshim, Ne e gjetëm (Ejubin) të duruar. Sa rob i mirë që ishte ai! Ishte shumë i përlur.

وَخُذْ بِيَدِكَ ضِعْفًا فَاصْرِبْ بِهِ وَلَا  
تَحْنُطْ ۗ إِنَّا وَجَدْنَاهُ صَابِرًا ۗ نِعْمَ الْعَبْدُ  
إِنَّهُ أَوَّابٌ ٤٥

46. Dhe kujto robërit Tanë, Ibrahimin, Is’hakun dhe Jakubin, që kanë pasur duar të fuqishme dhe ishin largpamës.<sup>12</sup>

وَاذْكُرْ عَبْدَنَا إِبْرَاهِيمَ وَأِسْحَاقَ وَيَعْقُوبَ  
أُولِي الْأَيْدِي وَالْأَبْصَارِ ٤٦

11. Ajetet 42 – 44: Vuajtjet që i kishte shkaktuar djalli *Hazret Ejubit*<sup>as</sup> ishin shumë të rënda. Sipas Biblës atë e kishte zënë një sëmundje e rëndë e lëkurës, dhe për këtë arsye, çdokush filloi ta urrente atë, madje edhe familja e tij, dhe e kishin flakur përjashta në një vend të papërshtatshëm. Sipas Kuranit Famëlartë, Allahu i Madhërisëm e porositi *Hazret Ejubin*<sup>as</sup> të shkonte te një burim i caktuar, ku ai do të gjente shërim. Pas shërimit, Allahu i Madhërisëm, jo vetëm që i dhuroi familjen, por edhe një xhemat flijues.

12. Zoti i Madhërisëm u dhuroi muslimanëve jo vetëm mendjen, por edhe dritën shpirtërore dhe komunikimin me Të, në mënyrë që ata të mos ndjekin vetëm oratorinë e thatë, por të ecin

47. Ne i zgjodhëm ata veçanërisht për kujtimin e *ahiretit*.

إِنَّا أَحْصَيْنَاهُمْ بِخَالِصَةِ ذِكْرِي الَّذَارِ ۝٤٧

48. Dhe, pa dyshim, ata pranë Nesh ishin ndër të zgjedhurit, (ndër) më të mirët.

وَأَنَّهُمْ عِندَنَا لَمِنَ الْمُصْطَفَيْنَ الْأَخْيَارِ ۝٤٨

49. Dhe kujto Ismailin, Eljesain<sup>13</sup> e Dhulkiflin.<sup>14</sup> Të gjithë ishin ndër më të mirët.

وَأَذْكُرُ إِسْمَاعِيلَ وَالْيَسَعَ وَذَا الْكِفْلِ ۝٤٩ وَكُلٌّ مِّنَ الْأَخْيَارِ ۝٥٠

50. Ky është një kujtim. Sigurisht, të druajturit (ndaj Zotit) do të kenë një vendkthim të bukur;

هَذَا ذِكْرٌ ۝ وَإِنَّ لِلْمُتَّقِينَ لَحُسْنَ مَّآبٍ ۝٥٠

51. kopshte të përhershme; (ku) ata i kanë të hapura dyert.<sup>15</sup>

جَبَّتْ عَدْنٌ مُّفْتَحَةً لَهُمُ الْأَبْوَابُ ۝٥١

52. Në to ata do të qëndrojnë të mbështetur (dhe) do të porosisin lloj-lloj frutash dhe pije.

مُتَّكِنِينَ فِيهَا يَدْعُونَ فِيهَا بِفَاكِهَةٍ كَثِيرَةٍ ۝ وَشَرَابٍ ۝٥٢

në rrugën e spiritualizmit. Ata që janë të pushtuar vetëm nga oratoria vetjake, i kanë të dobëta aftësitë shpirtërore. Duke përkthyer robërit e Tij, Zoti i Madhërisëm tha “ata kishin duar dhe shikim”, dhe nuk tha askund, për shembull, “kishin gjuhën” ose “ishin oratorë”. Pra, ata nuk jetonin në fantazi dhe nuk ndiqnin hamendjet, por ishin njerëz praktikë dhe i ftonin të tjerët duke pasur vetë dritën e Zotit. Kjo tregon që Zotit i pëlqejnë vetëm ata që e shohin me vëmendje Fjalën e Zotit, bëhen largpamës, më pas veprojnë fort sipas asaj. Por këto nuk mund t’i arrish pa e bërë pastrimin shpirtëror dhe pa i rregulluar aftësitë e tua të brendshme.

13. Eljesai (Eliseu) ishte dishepull dhe pasardhës i Profetit Iljas<sup>as</sup>. Ai jetoi nga viti 938 deri në vitin 828 p.e.s..

14. Dhulkifli ishte një Profet i Zotit, dhe mundet të jetë Profeti Ezekiel që përmendet në Bibël (Ezekiel 1:3), të cilin arabët mund ta kenë quajtur Dhulkifl.

15. Ngritja te Zoti është e destinuar për të gjithë Profetët dhe besimtarët. Pas vdekjes, çdo besimtar i vërtetë do të ketë ngritje te Zoti. Këto ajete pikërisht këtë e tregojnë që ata që kanë druajtje ndaj Zotit, i kanë të hapura portat e qiellit. Këtë ngritje për *Hazret Isain*<sup>as</sup> disa e quajnë si ngritje fizike. Kurse Kurani e ka sqaruar shumë qartë se për çdo besimtar hapen portat e qiellit pas vdekjes së tij. Dhe diku tjetër për mohuesit tha se atyre nuk do t’u hapen portat e qiellit (7:41). Pra, ata nuk do të kenë ngritje shpirtërore drejt Zotit. Lexoni edhe 4:159.

53. Pranë tyre do të jenë shoqet moshatare me shikim të ulur.<sup>16</sup>

وَعِنْدَهُمْ فُصِرَتُ الظَّرْفِ اَترَابٍ ٥٣

54. Kjo është ajo që ju premtohet për Ditën e Llogarisë.

هَذَا مَا تُوْعَدُونَ لِيَوْمِ الحِسابِ ٥٤

55. Kjo, pa dyshim, është dhurata Jonë që nuk shteron kurrë.

إِنَّ هَذَا لَرِزْقُنَا مَا لَهُ مِنْ نَفَادٍ ٥٥

56. Kjo është. Dhe sigurisht, rebelët do të kenë vendkthim të keq;

هَذَا وَإِنَّ لِلظَّالِمِينَ نَشْرًا مَا بِي ٥٦

57. xhehenemin! Do të hyjnë në të. Sa shtrat i keq është ai!

جَهَنَّمَ ۚ يَصْلَوْنَهَا ۚ فَيَنسُ المِهَادَ ٥٧

58. Kjo është. Dhe ata do ta shijojnë atë, pra, ujë të valuar e të qelbur.

هَذَا فَلْيَذُوقُوهُ حَمِيمٍ وَغَسَّاقٍ ٥٨

59. Do të kenë edhe gjëra të tjera të ngjashme me të.

وَآخَرَ مِنْ شَكْلِهِ اَرْوَابٍ ٥٩

60. Kjo është ushtria që do të zhytet (në të) bashkë me ju. Nuk do t'u bëhet mirësearchje. Ata do të hyjnë në zjarr.

هَذَا فَوْجٌ مُّقْتَضِمٌ مَعَكُمْ ۚ لَا مَرْحَبًا بِهِمْ ۗ إِنَّهُمْ صَالُوا النَّارِ ٦٠

61. Ata do t'u thonë (atyre që i mallkojnë): “Jo! Jeni ju të mallkuar! Nuk ka mirësearchje për ju! Jeni ju që na i shkaktuat të gjitha këto!”<sup>17</sup> Sa qëndrim i keq është ai!

قَالُوا بَلْ أَنْتُمْ ۚ لَا مَرْحَبًا بِكُمْ ۗ أَنْتُمْ قَدَّمْتُمُوهُ لَنَا ۚ فَيَنسُ اَلْقَرَارَ ٦١

62. Ata do të thonë: “O Zoti ynë! Atij që na e shkaktoi këtë, shtoja ndëshkimin dyfish në zjarr.

قَالُوا رَبَّنَا مَنْ قَدَّمَ لَنَا هَذَا فَرَدُّهُ عَدَابًا ۖ ضِعْفًا فِي النَّارِ ٦٢

16. Fjalët “me shikim të ulur” janë një shprehje e figurshme, e cila tregon se ato do të jenë të përlurura dhe ruajtëse të nderit.

17. Pasuesit e prijësve mohues do t'i mallkojnë udhëheqësit e vet me fjalët që përshkruan ky ajet. Si udhëheqësit, ashtu edhe ndjekësit do të mallkojnë njëri-tjetrin. Është natyra e njeriut të tillë që kur përballet me pasoja të liga të veprave të tij, ai përpiqet t'ua kalojë fajin të tjerëve.

63. Dhe do të thonë: “Çfarë kemi që nuk po shohim njerëz që i llogarisnim si keqbërës?”

وَقَالُوا مَا لَنَا لَا نَرَى رِجَالًا كُنَّا نَعُدُّهُمْ  
مِنَ الْأَشْرَارِ ﴿٦٣﴾

64. Mos i kemi tallur ata, apo sytë tanë kanë gabuar t’i dallojnë?”

أَتَخَذْنَاهُمْ سِحْرِيًّا أَمْ زَاغَتْ عَنْهُمْ  
الْأَبْصَارُ ﴿٦٤﴾

65. Pa dyshim, kjo grindje e banorëve të zjarrit është e vërtetë.

إِنَّ ذَٰلِكَ لِحَقٌّ تَخَاصُمُ أَهْلِ النَّارِ ﴿٦٥﴾

66. Thuaj: Unë jam vetëm një alarmues dhe nuk ka të adhurueshëm tjetër përveç Allahut (që është) i Vetmi, Mbizotëruesi.

قُلْ إِنَّمَا أَنَا مُنذِرٌ ۖ وَمَا مِن إِلَهٍ إِلَّا اللَّهُ  
الْوَاحِدُ الْقَهَّارُ ﴿٦٦﴾

67. Zoti i qiejve, i tokës dhe i asaj që gjendet mes tyre, i Gjithëfuqishmi, Falësi.

رَبُّ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا الْعَزِيزُ  
الْغَفَّارُ ﴿٦٧﴾

68. Thuaj: “Ky është një lajm madhështor,

قُلْ هُوَ نَبَأٌ عَظِيمٌ ﴿٦٨﴾

69. të cilin ju e shmangni.

أَنْتُمْ عَنْهُ مُعْرِضُونَ ﴿٦٩﴾

70. Unë nuk kisha asnjë dijeni të Parisë së Lartë, kur ata po debatonin.<sup>18</sup>

مَا كَانَ لِي مِنْ عِلْمٍ بِالْمَلَأِ الْأَعْلَىٰ إِذْ  
يَخْتَصِمُونَ ﴿٧٠﴾

18. Asnjë njeri që bëhet Profet, përpara se Zoti ta zgjedhë atë, nuk ushqen në zemër asnjë dëshirë të fshehtë që ai të bëhet sundues ose lider i njerëzve. Profetët përpara se të marrin profetërinë, preferojnë të jetojnë në vetmi dhe të mënjanuar nga njerëzit. Më pas Zoti i nxjerr ata me urdhrin e Tij. Atëherë ata detyrohen të dalin në publik. *Hazret* Musai<sup>as</sup>, për shembull, nuk kishte as dëshirën më të vogël që të bëhej prijës i popullit të tij. Madje, kur Zoti e njoftoi për këtë detyrë, i paraqiti justifikime të ndryshme. I tha – Cakto vëllain, ai është më elokuent se unë. Në të njëjtën mënyrë, ky ajet pasqyron ndjenjat e Profetit Muhammed<sup>sav</sup>, dhe ai u thotë njerëzve – Unë nuk kisha asnjë dijeni për Parinë e Lartë se çfarë po debatonin ata për profetërinë time! Ky ajet gjithashtu tregon se kur Zoti vendos të ngrejë në botë një profet, Ai ua zbulon dëshirën e Tij atyre engjëjve që janë më të afërt me Të dhe të cilët quhen “Paria e Lartë”. Këta engjëj diskutojnë mes tyre këtë çështje të rëndësishme. Një ngjarje e tillë përmendet në 2:31 për çështjen e *Hazret* Ademit. Edhe këtu, pas një ajeti, Zoti e sjell shembullin e Ademit<sup>as</sup>.

71. Vetëm se mua më shpallet që unë jam thjesht alarmues i qartë.”

إِن يُوحَىٰ إِلَىٰ إِلَّا أَنَّمَا أَنَا نَذِيرٌ مُّبِينٌ ﴿٧١﴾

72. Kur Zoti yt u tha engjëjve: “Sigurisht, Unë do të krijoj një njeri prej dheu.

إِذْ قَالَ رَبُّكَ لِلْمَلَكَةِ إِنِّي خَالِقٌ بَشَرًا مِّنْ طِينٍ ﴿٧٢﴾

73. E kur ta plotësoj atë, e të fryj në të prej shpirtit Tim, ju bini në sexhde për të.”

فَإِذَا سَوَّيْتُهُ وَنَفَخْتُ فِيهِ مِنْ رُّوحِي فَقَعُوا لَهُ سَاجِدِينَ ﴿٧٣﴾

74. Atëherë, engjëjt bënë sexhde, që të gjithë.<sup>19</sup>

فَسَجَدَ الْمَلَائِكَةُ كُلُّهُمْ أَجْمَعُونَ ﴿٧٤﴾

75. Por Iblisi jo. Ai u tregua mendjemadh dhe ishte nga mohuesit.

إِلَّا ابْلِيسَ ۖ اسْتَكْبَرَ ۖ وَكَانَ مِنَ الْكٰفِرِينَ ﴿٧٥﴾

76. (Zoti) tha: “O Iblis! Çfarë të ndaloi të bëje sexhde për atë që kam krijuar me të dyja Duart e Mia? A u tregove mendjemadh apo u ndjeve i lartë?”

قَالَ يَا اِبْلِيسُ مَا مَنَعَكَ اَنْ تَسْجُدَ لِمَا خَلَقْتُ بِئِدْيَ ۖ اَسْتَكْبَرْتَ اَمْ كُنْتَ مِنَ الْعٰلِينَ ﴿٧٦﴾

19. Porosia për të rënë në sexhde nuk është e lidhur me kohën kur lindi Hazret Ademi<sup>as</sup>, por është e mëvonshme (pra, kur iu përsos shpirti). Kur një njeri arrin pozitën më të lartë të të qenit njeri, kur ai bëhet i baraspeshuar në aftësitë e tij njerëzore dhe kur Shpirti prej Zotit hyn në të, atëherë Zoti u thotë engjëjve – Bini në sexhde përpara këtij njeriu të përsosur. Që, me fjalë të tjera, do të thotë – Zbrisni tek ai me dritat qiellore dhe dërgojini atij *salavate* dhe selam. Kjo është praktika e hershme e Zotit me robërit e Tij të zgjedhur. Kur një njeri i një epoke të caktuar arrin përsosmërinë shpirtërore dhe Shpirti prej Zotit hyn në të, domethënë, *nefsi* i tij asgjësohet dhe Zoti i jep një jetë të re shpirtërore, engjëjt fillojnë t'i zbresin atij në një mënyrë të veçantë. Ndonëse edhe në fazat e para të rrugëtimit të tij shpirtëror engjëjt e ndihmojnë dhe i shërbejnë, kjo zbritje (në kohën e caktimit si profet) bëhet aq e plotë dhe e përsosur, saqë ngjason me sexhden. Duke e përdorur këtu fjalën *sexhde*, Zoti i Madhërishtëm tregoi që, engjëjt nuk janë më të lartë në pozitë sesa njeriu i përsosur, madje, porsì shërbëtorë mbretërorë, ata vazhdimisht përkulen përpara njeriut të përsosur. Përveç kësaj, fjalët “engjëj” nuk nënkuptojnë vetëm engjëjt e Zotit, por edhe njerëzit e dëlirë, të cilët si engjëj të bindur i bashkohen Profetit të Zotit.

77. (Iblisi) tha: “Unë jam më i mirë se ai; mua më krijove prej zjarri kurse atë e krijove prej dheu.”<sup>20</sup>

قَالَ أَنَا خَيْرٌ مِنْهُ ط حَلَقْتَنِي مِنْ نَّارٍ  
وَحَلَقْتَهُ مِنْ طِينٍ ﴿٧٧﴾

78. (Zoti) tha: “Dil nga këtu! Ti je i përzënë.”

قَالَ فَاحْرُجْ مِنْهَا فَإِنَّكَ رَجِيمٌ ﴿٧٨﴾

79. Dhe do të kesh mbi vete mallkimin Tim deri në Ditën e Gjykimit.”

وَإِنَّ عَلَيْكَ لَعْنَتِي إِلَى يَوْمِ الدِّينِ ﴿٧٩﴾

80. Ai tha: “O Zoti im! Jepmë afat deri në ditën kur (njerëzit) do të ringjallen!”

قَالَ رَبِّ فَأَنْظِرْنِي إِلَى يَوْمِ يُبْعَثُونَ ﴿٨٠﴾

81. (Zoti) tha: “Ti je ndër ata që u kam dhënë afat.”

قَالَ فَإِنَّكَ مِنَ الْمُنْظَرِينَ ﴿٨١﴾

82. Deri në ditën e një kohe të caktuar.”

إِلَى يَوْمِ الْوَقْتِ الْمَعْلُومِ ﴿٨٢﴾

83. (Iblisi) tha: “Atëherë, betohem për nderin Tënd! Unë patjetër do t'i devijoj të gjithë ata.

قَالَ فَبِعِزَّتِكَ لأَعُوْبِيَهُمْ أَجْمَعِينَ ﴿٨٣﴾

84. Përveç robërve të Tu nga ata, që janë të zgjedhurit (e Tu).”

إِلَّا عِبَادَكَ مِنْهُمْ الْمُخْلِصِينَ ﴿٨٤﴾

85. (Zoti) tha: “E vërteta është, dhe Unë të vërtetën e them,

قَالَ فَالْحَقُّ وَالْحَقُّ أَقْوَلُ ﴿٨٥﴾

86. do të mbush patjetër xhehenemin me ty dhe me të gjithë ata që do të të ndjekin ty.”

لَأَمْلَأَنَّ جَهَنَّمَ مِنْكَ وَمِمَّنْ تَبَعَكَ مِنْهُمْ  
أَجْمَعِينَ ﴿٨٦﴾

87. Thuaj (o Profet): Nuk ju kërkoj ndonjë shpërblim për këtë dhe unë nuk jam as ndër ata që shtiren.

قُلْ مَا أَسْأَلُكُمْ عَلَيْهِ مِنْ أَجْرٍ وَ مَا أَنَا مِنَ الْمُتَكَلِّفِينَ ﴿٨٧﴾

20. Lexoni 7:14.

88. Kjo është vetëm këshillë për botët.

إِنَّ هُوَ إِلَّا ذِكْرٌ لِلْعَالَمِينَ ﴿٨٨﴾

89. Dhe ju do ta mësoni patjetër lajmin e saj pas pak kohe.

وَلَتَعْلَمَنَّ بَأَهٗ بَعْدَ حِينٍ ﴿٨٩﴾

## Surja 39 – Ez-Zumer

Surja Ez-Zumer është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka shtatëdhjetë e gjashtë ajete.

Në fund të sures paraardhëse u tha për robërit e sinqertë që ia përkushtojnë fenë vetëm Allahut, që mohojnë të adhurojnë djallin dhe qëndrojnë duke bërë *ibadet* (adhurim) dhe sexhde përpara Zotit të Madhërishëm. Kurse kjo sure që në fillim jep porosinë – O i Dërguar! Adhuro Allahun duke ia përkushtuar fenë vetëm Atij, sepse Allahu, pa dyshim, pranon vetëm besimin e pastër.

Më pas, kjo sure hedh poshtë argumentin e idhujtarëve që pretendojnë se ata i adhurojnë zotat e tjerë, në mënyrë që zotat t’u bëhen ndërmjetës dhe t’u mundësojnë afrimin me Zotin. Zoti thotë: Aspak nuk është kështu, madje, ndërmjetës mund të bëhet vetëm ai që ka fenë kaq të pastër siç është feja e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, pasi nuk ka asnjë grimë idhujtarie në fenë e tij.

Mandej kjo sure përsërit faktin që jeta njerëzore filloi me një shpirt të vetëm. Dhe gjithashtu, kur njeriu si fetus filloi të zhvillohej në mitrën e nënës, ai qëndron i fshehur në tri errësira. Tri errësira shkaktohen nga tri pjesë të ndryshme të nënës, ku e para është barku i saj që mbulon mitrën, e dyta është vetë mitra në të cilën zhvillohet fëmija dhe, e treta është placenta që mbështjell fëmijën brenda mitrës.

Në vijim, Zoti porositi të Dërguarin e Allahut<sup>savs</sup> të deklarojë: *Unë jam urdhëruar t’ia përkushtoj besimin vetëm Atij, më pas edhe këtë: Thuaj: Allahun e adhuroj, duke ia përkushtuar besimin vetëm Atij. Dhe ju adhuroni kë të doni duke e lënë Allahun, por ta dini se do të pësoni humbjen më të madhe, jo vetëm për veten tuaj, por edhe për familjet dhe pasardhësit tuaj.*

Pastaj në një ajet tjetër thuhet:

*Atij që Allahu ia hapi zemrën për Islamin dhe ai qëndron në dritë prej Zotit të tij, a mund të jetë (si ata që nuk e kujtojnë Zotin)?* Në dukje, kësaj pyetjeje nuk i është përgjigjur, por kjo është një pyetje retorike dhe përgjigjja është që pikërisht njeriu i tillë është më i miri dhe, nga ana tjetër, nuk ka njeri më fatzi se ai që mbetet i shkujdesur nga përkujtimi i Zotit të tij.

Në ajetin nr. 24 të kësaj sureje thuhet se Allahu i zbriti Profetit<sup>savs</sup> një Libër shumë të bukur, shumë elokuent dhe që përsëritet vazhdimisht, disa ajete të të cilit kanë ngjasime me njëra-tjetrën. Por, po në këtë Kuran ka edhe ajete të tjera që i shpjegojnë ato të parat dhe që u japin dritë kërkimtarëve për të kuptuar të vërtetën. Kjo është ajo që thuhet në një thënie: “Një pjesë e Kuranit shpjegon një pjesë tjetër të tij.” Në një ajet tjetër të Kuranit thuhet se për ata që janë të thelluar në dije, asnjë ajet i Kuranit nuk është i paqartë.

Po në këtë sure vjen ajeti, një pjesë të të cilit Allahu i Madhërishëm i dërgoi si shpallje



edhe Mesihut të Premtuar<sup>as</sup>. Më pas, Mesihu i Premtuar<sup>as</sup> porositi t'i përgatitej një unazë e gdhendur me fjalët që iu shpallën: *الَّذِينَ اللَّهُ بِكَافٍ عَبْدَهُ* “A nuk i mjafton Allahu robit të Vet?!”

Bazuar te kjo ngjarje, shumë nga muslimanët ahmedianë mbajnë unazë me mbishkrimin e këtyre fjalëve, për bekim dhe për ogur të mirë.

Ajeti 43 i kësaj sureje zbulon një sekret të madh duke pohuar se edhe gjumi është një lloj vdekjeje, në të cilën shpirti i njeriut vazhdimisht zhytet, dhe këtu me *shpirt* nënkuptohet nënvetëdija e tij. Allahu i Madhërishëm ndërtoi këtë sistem në atë mënyrë që nënvetëdija në një moment të caktuar përplaset me thellësinë e trurit dhe më pas rikthehet. Sipas shkencëtarëve ky fenomen ndodh disa herë me njeriun në një kohë të caktuar gjatë gjumit. Kjo kohë është aq e llogaritur, sa mund të matet me një orë elektronike. Më pas, Allahu i Madhërishëm kur nuk e lejon shpirtin e zhytur të rikthehet, trupi pëson vdekje.

Ndërsa flitet për largimin e përhershëm nga kjo botë për t'u paraqitur më pas përpara Allahut të Madhërishëm, atyre që kanë frikë nga llogaridhënia, kjo sure u jep edhe lajmin e mirë duke thënë të mos dëshpërohen nga mëshira e Allahut dhe se Allahu ka fuqi të plotë t'ua falë të gjitha mëkatet, sepse Ai është shumë Falës dhe shumë Mëshirëbërës. Andaj, u bëhet thirrje që ata të përulen para Zotit, të pendohen dhe Atij t'i dorëzohen tërësisht, përpara se t'u vijë ndëshkimi ose vdekja dhe përpara se atyre t'u mbetet vetëm të dëshpërohen e të thonë – Ah sikur të mos kisha guxuar të bëja kaq shumë mëkate para syve të Zotit!

Kjo sure quhet Ez-Zumer, d.m.th. “Grupet” dhe në fund të saj ka dy ajete që ndajnë njerëzit në dy grupe: një grup është i atyre, të cilët do të shtyhen grupe-grupe drejt xhehenemit dhe grupi tjetër është i atyre që do të drejtohen drejt xhenetit.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Zbritja e Librit është prej Allahut, Mbizotëruesit, të Urtit.

تَنْزِيلَ الْكِتَابِ مِنَ اللَّهِ الْعَزِيزِ الْحَكِيمِ ①

3. Pa dyshim, Ne të zbritëm Librin me të vërtetën, andaj, adhuro Allahun duke ia përkushtuar fenë vetëm Atij.

إِنَّا أَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ فَاعْبُدِ اللَّهَ مُخْلِصًا لَهُ الدِّينَ ①

4. Dëgjoni! Pikërisht Allahut i duhet përkushtuar feja. Kurse ata që zgjodhën miq të tjerë përveç Tij, (thonë): “Ne i adhurojmë vetëm që ata të na afrojnë një vend më afër drejt Allahut.” Sigurisht, Allahu do të gjykojë mes tyre në çështjet që ata kundërshtonin. Allahu nuk udhëzon atë që është gënjeshtar (dhe) tepër mosmirënjohës.

أَلَا لِلَّهِ الدِّينُ الْخَالِصُ ۗ وَالَّذِينَ اتَّخَذُوا مِنْ دُونِهِ أَوْلِيَاءَ ۗ مَا نَعْبُدُهُمْ إِلَّا لِيُقَرِّبُونَا إِلَى اللَّهِ زُلْفَىٰ ۗ إِنَّ اللَّهَ يَحْكُمُ بَيْنَهُمْ فِي مَا هُمْ فِيهِ يَخْتَلِفُونَ ۗ إِنَّ اللَّهَ لَا يَهْدِي مَنْ هُوَ كَذِبٌ كَفَّارٌ ①

5. Po të donte Allahu të kishte ndonjë djalë, do të zgjidhte çfarë të donte nga ato që Ai ka krijuar. I pastër është Ai (nga kjo e metë). Pikërisht Ai Allah është i Vetmi, Mbizotëruesi.

لَوْ أَرَادَ اللَّهُ أَنْ يَتَّخِذَ وَلَدًا لَأَصْطَفَىٰ مِنْهَا مَنْ يَخْلُقُ مَا يَشَاءُ ۗ لَا سُبْحَانَ ۗ هُوَ اللَّهُ الْوَاحِدُ الْقَهَّارُ ①

6. Ai krijoi qiejt dhe tokën me vërtetësi. Ai mbulon natën me ditën dhe mbulon ditën me natën, dhe vuri në shërbim diellin dhe hënën. Secili lundron drejt një afati të caktuar. Dëgjoni! Ai është i Plotfuqishmi, Falësi.

خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ بِالْحَقِّ ۗ يَكْوَرُ أَيْلَ عَلَى النَّهَارِ وَ يَكْوَرُ النَّهَارَ عَلَى الْإِيلِ وَسَخَّرَ الشَّمْسَ وَالْقَمَرَ ۗ كُلٌّ يَجْرِي لِأَجَلٍ مُسَمًّى ۗ أَلَا هُوَ الْعَزِيزُ الْغَفَّارُ ①

7. Ai ju krijoi nga një shpirt i vetëm, më pas prej tij bëri çiftin e tij dhe për ju zbriti tetë çifte të bagëtive.<sup>1</sup> Ai ju krijon në barqet e nënave tuaja, krijim pas krijimi, në tri errësira. Ky është Allahu, Zoti juaj, i Atij është sundimi. Nuk ka të adhurueshëm tjetër përveç Atij. Atëherë ku po largoheni ju?!

8. Nëse mohoni, atëherë Allahu është i Pavarur nga ju. Ai nuk e pëlqen mohimin për robërit e Tij, dhe nëse falënderoni, këtë do ta pëlqejë për ju. Asnjë mbartës nuk do të mbajë barrën e tjetrit. Më pas te Zoti juaj është kthimi juaj, atëherë Ai do t'ju tregojë se çfarë bënit ju. Pa dyshim, Ai është i Gjithëdijshëm për sekretet që mbajnë kraharorët.

9. Dhe kur njeriun e prek ndonjë shqetësim, ai i lutet Zotit të tij duke anuar nga Ai. Më pas, kur (Zoti) i dhuron ndonjë mëshirë prej Vetes, ai e harron për çfarë i ishte lutur Atij deri më parë dhe fillon të bëjë ortakë për Allahun, që ata ta largojnë atë nga rruga e Tij. Thuaj: Përfito pak me

حَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ ثُمَّ جَعَلَ مِنْهَا  
زَوْجَهَا وَأَنْزَلَ لَكُمْ مِنَ الْأَنْعَامِ ثَمَنِيَّةً  
أَزْوَاجًا يُحَلِّقُكُمْ فِي بُطُونِ أُمَّهَاتِكُمْ خَلْقًا  
مِنْ بَعْدِ خَلْقٍ فِي ظُلُمَاتٍ ثَلَاثٍ ذُرِّيَّتُكُمْ اللَّهُ  
رَبُّكُمْ لَهُ الْمُلْكُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ فَآلَىٰ  
تُصَرِّفُونَ ﴿٧﴾

إِنْ تَكْفُرُوا فَإِنَّ اللَّهَ غَنِيٌّ عَنْكُمْ وَلَا  
يَرْضَىٰ لِعِبَادِهِ الْكُفْرَ وَإِنْ تَشْكُرُوا يَرْضَهُ  
لَكُمْ وَلَا تَزِرُ وَازِرَةٌ وِزْرَ أُخْرَىٰ ثُمَّ  
إِلَىٰ رَبِّكُمْ مَرْجِعُكُمْ فَيُنَبِّئُكُمْ بِمَا كُنْتُمْ  
تَعْمَلُونَ ﴿٨﴾ إِنَّهُ عَلِيمٌ بِذَاتِ الصُّدُورِ ﴿٩﴾

وَإِذَا مَسَّ الْإِنْسَانَ ضُرٌّ دَعَا رَبَّهُ مُنِيبًا  
إِلَيْهِ ثُمَّ إِذَا حَوَّلَهُ نِعْمَةً مِنْهُ نَسَىٰ مَا كَانَ  
يَدْعُوًا إِلَيْهِ مِنْ قَبْلٍ وَجَعَلَ لِلَّهِ أَنْدَادًا  
لِيُضِلَّ عَنْ سَبِيلِهِ ﴿٩﴾ قُلْ تَمَتَّعْ بِكُفْرِكَ

1. Fjala *enzele* në shqip përkthehet “ai zbriti”, por në këtë ajet është përdorur në kuptimin “ai krijoi”, pra për të treguar krijimin e disa krijesave që janë tejet të dobishme për njeriun. Kështu, folja “zbriti” nuk është përdorur në kuptimin e drejtpërdrejtë, atë të zbritjes fizike prej qiellit. Të gjithë e dimë se bagëtitë nuk bien prej qiellit, siç bie shi, e megjithatë, Kurani i Shenjtë edhe për to përdori fjalën “zbriti”, pasi bagëtitë i sjellin mbarë njerëzimit dobi e përfitime të panumërta. E njëjta “zbritje” përdoret edhe për ardhjen e dytë të *Hazret Isait*<sup>as</sup>, madje, mbi të gjithë, në Kurani e Shenjtë, folja “zbritje” përdoret edhe për Profetin Muhammed<sup>savs</sup>, siç thuhet: “*Sigurisht, Allahu zbriti për ju këshillë (dhe) të dërguar*” (65:11-12). Të gjithë dijetarët muslimanë dinë dhe besojnë se Profeti Muhammed<sup>savs</sup> nuk zbriti fizikisht prej qiellit. Prandaj, atyre u duhet të rishikojnë besimin e tyre në lidhje me “zbritjen e *Hazret Isait*<sup>as</sup>”, për të cilin presin që Allahu i Madhërishtëm t’ua zbresë fizikisht prej qiellit. Lexoni edhe 5:118.

mohimin tënd; ti, sigurisht që je nga banorët e zjarrit.

قَلِيلًا ۙ إِنَّكَ مِنْ أَصْحَابِ النَّارِ ۝١

10. Ai që adhuron orëve të natës, duke bërë sexhde e duke qëndruar në këmbë, duke pasur frikë nga *ahireti* dhe duke shpresuar mëshirën e Zotit të tij, a nuk (gëzon dije të qartë?!) Pyet: A mund të barazohen ata që dinë dhe ata që nuk dinë?! Pa dyshim, këshillën e pranojnë vetëm të mençurit.

أَمَّنْ هُوَ قَانَتْ ۙ إِنَّا إِلِيلٌ سَاجِدًا ۙ وَقَائِمًا  
يَحْدُرُ ۙ الْأَحْرَةَ ۙ وَيَرْجُوا رَحْمَةَ رَبِّهِ ۙ قُلْ  
هَلْ يَسْتَوِي الَّذِينَ يَعْلَمُونَ وَالَّذِينَ  
لَا يَعْلَمُونَ ۙ إِنَّمَا يَتَذَكَّرُ ۙ أُولُو الْأَلْبَابِ ۝٢

11. Thuaj: O robërit e mi që besuat! Kini druajtje ndaj Zotit tuaj! Për ata që bëjnë mirësi, do të ketë mirësi edhe në këtë botë. Toka e Allahut është e gjerë. Pa dyshim, të duruarve do t'u jepet shpërblimi i tyre pa masë.<sup>2</sup>

قُلْ لِعِبَادِ الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا رَبَّكُمْ ۙ لِلَّذِينَ  
أَحْسَنُوا فِي هَذِهِ الدُّنْيَا حَسَنَةٌ ۙ وَأَرْضُ  
اللَّهِ وَاسِعَةٌ ۙ إِنَّمَا يُوَفَّى الصَّابِرُونَ أَجْرَهُمْ  
بِعَٰجِرِ حِسَابٍ ۝٣

12. Thuaj: Unë jam urdhëruar të adhuroj Allahun, duke ia përkushtuar fenë vetëm Atij.

قُلْ إِنِّي أُمِرْتُ أَنْ أَعْبُدَ اللَّهَ مُخْلِصًا لَهُ  
الدِّينَ ۝٤

13. Dhe jam urdhëruar që të bëhem i pari i të nënshtruarve.

وَأُمِرْتُ لِأَنْ أَكُونَ ۙ أَوَّلَ الْمُسْلِمِينَ ۝٥

14. Thuaj: Nëse bëhem i pabindur ndaj Zotit tim, kam frikë për ndëshkimin e një dite të rëndë.

قُلْ إِنِّي أَخَافُ ۙ إِنْ عَصَيْتُ رَبِّي عَذَابَ  
يَوْمٍ عَظِيمٍ ۝٦

15. Thuaj: Allahun e adhuroj, duke ia përkushtuar fenë time vetëm Atij.<sup>3</sup>

قُلِ اللَّهُ أَعْبُدْ مُخْلِصًا لَهُ دِينِي ۝٧

2. Ajeti bën profeci për besimtarët se ata do të kalojnë nëpër sprova të mundimshme dhe do t'u duhet të lënë vatrat dhe shtëpitë e tyre për hir të Zotit. Dhe pasi ta kenë kaluar me sukses vështirësinë, do ta gjejnë të gjerë tokën e Zotit dhe do të kenë shpërblimin e tyre të plotë prej Zotit.

3. Në kaq pak ajete, katër herë u përmend që Pejgamberi<sup>savs</sup> është urdhëruar ta adhurojë Allahun duke ia përkushtuar fenë vetëm Atij (ajeti 3, 4, 12 dhe 15). Këto ajete duket se po i përgatisnin muslimanët për sprovat e rënda që i prisnin në Medinë. Kjo sure u zbrit në vitet

16. Andaj, ju adhuroni kë të doni duke e lënë Atë. Thuaj: humbësit e vërtetë, pa dyshim, janë ata që u shkakjuan humbje vetvetes dhe familjeve të tyre Ditën e Kiametit. Dëgjoni! Kjo pikërisht është humbje e qartë!

17. Ata do të kenë hije zjarri sipër tyre dhe, edhe hije nën ta. Kjo është ajo prej së cilës Allahu i frikëson robërit e Tij. O robërit e Mi, kini druajtje ndaj Meje!

18. Dhe ata që u ruajtën nga idhujt,<sup>4</sup> pra, nga adhurimi i tyre, dhe anuan tek Allahu, do të kenë lajmin e mirë. Andaj, jepu lajmin e mirë robërve të Mi;

19. atyre që e dëgjojnë fjalën me vëmendje dhe zbatojnë më të bukurën e saj. Pikërisht këta i udhëzoi Allahu dhe pikërisht këta janë të mençur.

20. A mund të (shpëtojë) ai për të cilin u vërtetua fjala për ndëshkim?! Ti a mund ta lirosh atë që është në zjarr?!

21. Por ata që patën druajtje ndaj Zotit të tyre, do të kenë dhoma të ndërtuara sipër dhomave të tjera, (dhe) nën to do të rrjedhin lumenj.

e fundit të periudhës mekase, kur muslimanët po largoheshin për në Medine, të vetëm ose në grupe të vogla. Njëkohësisht, këto kanë një mesazh të qartë edhe për muslimanët e sotëm në veçanti, dhe për gjithë njerëzimin në përgjithësi.

4. Në këtë ajet është përdorur fjala “*tāgūt*”, që do të thotë “*rebelë*”. Komentuesit në përgjithësi nga kjo nënkuptojnë *idhujt*.

فَاعْبُدُوا مَا شِئْتُمْ مِنْ دُونِهِ ۗ قُلْ إِنَّ  
الْخَيْرِينَ الَّذِينَ خَسِرُوا أَنْفُسَهُمْ  
وَأَهْلِيَهُمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ ۗ أَلَا ذَلِكَ هُوَ  
الْخُسْرَانُ الْمُبِينُ ﴿١٦﴾

لَهُمْ مِنْ فَوْقِهِمْ ظُلَلٌ مِنَ النَّارِ وَمِنْ  
تَحْتِهِمْ ظُلَلٌ ۗ ذَلِكَ يُخَوِّفُ اللَّهَ بِهِ  
عِبَادَهُ ۗ يُعْبَادِ فَاتَّقُونِ ﴿١٧﴾

وَالَّذِينَ اجْتَنَبُوا الطَّاغُوتَ أَنْ يَعْبُدُوهَا  
وَأَنَابُوا إِلَى اللَّهِ لَهُمُ الْبُشْرَىٰ ۗ فَبَشِّرْ  
عِبَادِ ﴿١٨﴾

الَّذِينَ يَسْمَعُونَ الْقَوْلَ فَيَتَّبِعُونَ أَحْسَنَهُ ۗ  
أُولَٰئِكَ الَّذِينَ هَدَاهُمُ اللَّهُ وَأُولَٰئِكَ هُمُ  
أُولُو الْأَلْبَابِ ﴿١٩﴾

أَفَمَنْ حَقَّ عَلَيْهِ كَلِمَةُ الْعَذَابِ ۗ أَفَأَنْتَ  
تُنقِذُ مَنْ فِي النَّارِ ﴿٢٠﴾

لَكِنِ الَّذِينَ اتَّقَوْا رَبَّهُمْ لَهُمْ عُرفٌ مِّنْ  
فَوْقِهَا عُرفٌ مَّبْنِيَّةٌ تَجْرِي مِّنْ تَحْتِهَا  
الْأَنْهَارُ ۗ وَعَدَّ اللَّهُ ۗ لَا يُخْلِفُ اللَّهُ

(Ky) është premtimi i Allahut. Allahu nuk i shkel premtimet.

الْمِعَادِ ۝۱۱

22. A nuk e ke parë se Allahu zbriti ujë prej qiellit, më pas e bëri të rrjedhë në formë burimesh në tokë, më pas prej tij nxjerr bimësi të ngjyrave të ndryshme, më pas ajo thahet dhe ti e sheh të zverdhur, më pas Ai e shndërron në byk?! Në të, pa dyshim, për të mençurit ka një këshillë të madhe.

أَلَمْ تَرَ أَنَّ اللَّهَ أَنْزَلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَسَلَكَهُ  
يَنْبِيعَ فِي الْأَرْضِ ثُمَّ يُخْرِجُ بِهِ زَرْعًا  
مُّخْتَلِفًا أَلْوَانُهُ ثُمَّ يَهَيِّجُ فَتَرَاهُ مُصْفَرًّا  
ثُمَّ يَجْعَلُهُ حُطَامًا إِنَّ فِي ذَلِكَ لَذِكْرَى  
لِأُولِي الْأَبْصَارِ ۝۱۱

23. Atëherë, ai të cilit Allahu ia hapi zemrën për Islamit dhe që qëndron në dritë prej Zotit të tij, a mund të jetë (si ata që nuk e kujtojnë Zotin)?! Andaj, u mjerofshin ata që i kanë të ngurta zemrat (duke e privuar veten) nga kujtimi i Allahut! Pikërisht këta janë në humbje të qartë.<sup>5</sup>

أَفَمَنْ شَرَحَ اللَّهُ صَدْرَهُ لِلْإِسْلَامِ فَهُوَ  
عَلَى نُورٍ مِّنْ رَبِّهِ ۗ فَوَيْلٌ لِلْقَاسِيَةِ قُلُوبُهُمْ  
مِّنْ ذِكْرِ اللَّهِ ۗ أُولَٰئِكَ فِي ضَلَالٍ مُّبِينٍ ۝۱۲

24. Allahu zbriti fjalën më të bukur, një Libër që ka (ajete me) ngjasime (dhe që) përsëriten shpesh; nga ai u rrëqethet trupi atyre që i frikësohen Zotit të vet, pastaj u zbuten lëkurat dhe zemrat nga kujtimi i Allahut. Ky është udhëzimi i Allahut, me të cilin Ai udhëzon kë të dojë. Dhe atë që Allahu e cilëson të devijuar, nuk ka më udhëzues për të.<sup>6</sup>

اللَّهُ نَزَّلَ أَحْسَنَ الْحَدِيثِ كِتَابًا مُّتَشَابِهًا  
مَّثَانِيًّا ۗ تَفْصِيرٌ مِنْهُ جُلُودٌ الَّذِينَ يَحْسُونَ  
رَبَّهُمْ ۗ ثُمَّ تَلِينُ جُلُودُهُمْ وَقُلُوبُهُمْ إِلَىٰ  
ذِكْرِ اللَّهِ ۗ ذَلِكَ هَدَىٰ اللَّهُ يَهْدِي بِهِ  
مَنْ يَشَاءُ ۗ وَمَنْ يُضِلِلِ اللَّهُ فَمَا لَهُ  
مِنْ هَادٍ ۝۱۳

5. Mësimet e Islamit janë kaq tërheqëse dhe ndikuese saqë hyjnë lirshëm në zemrat e besimtarëve dhe ua shtojnë dijen dhe dashurinë Hyjnore, përveçse nëse dikush vetë e mbyll zemrën që të mos i hyjë përmendja e Allahut. Lexoni edhe 6:126.

6. Forma më e plotë dhe më shprehëse e shpalljes Hyjnore është ajo që është në Kuran. Në këtë ajet Kurani përshkruhet si *kitabën muteshabihen*, “një libër me ngjasime”, gjë që tregon se Kurani e ka si veti shumëkuptimësinë, por për këtë, duhet që ajetet ta mbështesin njëra-tjetrën, pasi ato janë të ngjashme. Nëse e studion Kuranin me këtë metodë, nuk gjen dot asnjë kontradiktë a mospërputhje në asnjë ajet të tij. Kjo natyrisht përbën një nga përsosmëritë

25. Ai që do ta përdorë fytyrën e vet për të shpëtuar nga ndëshkimi më i rëndë Ditën e Kiametit, a mund (t'ia dalë?!). Dhe keqbërësve do t'u thuhet: “Shijoni atë për të cilën keni punuar!”

أَفَمَنْ يَتَّقِي بِوَجْهِهِ سُوءَ الْعَذَابِ يَوْمَ الْقِيَامَةِ وَقِيلَ لِلظَّالِمِينَ ذُوقُوا مَا كُنتُمْ تَكْسِبُونَ ﴿٢٥﴾

26. (Edhe) ata që ishin para tyre mohuan, dhe atyre u erdhi ndëshkimi prej atje (ku) ata as nuk mund ta parafytyronin.

كَذَّبَ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ فَآتَاهُمُ الْعَذَابَ مِنْ حَيْثُ لَا يَشْعُرُونَ ﴿٢٦﴾

27. Atëherë, Allahu i bëri të shijonin poshtërimin që në jetën e kësaj bote, kurse ndëshkimi i *ahiretit* është (edhe) më i madh. Sikur ta dinin!

فَإِذَا قَهَّمُ اللَّهُ الْخُرَىٰ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَلِعَذَابِ الْأَخِرَةِ أَكْبَرُ لَوْ كَانُوا يَعْلَمُونَ ﴿٢٧﴾

28. Pa dyshim, Ne, në këtë Kuran, kemi paraqitur çdolloj shembulli për njerëzit, që të mendohen.

وَلَقَدْ صَرَبْنَا لِلنَّاسِ فِي هَذَا الْقُرْآنِ مِنْ كُلِّ مَثَلٍ لَعَلَّهُمْ يَتَذَكَّرُونَ ﴿٢٨﴾

29. (Zbritëm) një Kuran shumë elokuent, pa asnjë shtrembërim, që ata të kenë druajtje (ndaj Zotit).

قُرْآنًا عَرَبِيًّا غَيْرَ ذِي عِوَجٍ لَعَلَّهُمْ يَتَّقُونَ ﴿٢٩﴾

e tij të paimitueshme. Një tjetër përsosmëri e Kuranit qëndron në faktin se ai ka përdorur metafora, alegori, simbole dhe të gjitha metodat e ligjëritimit që sot njihen edhe si format letrare, për t'ia mësuar njeriut sa më qartë mesazhin Hyjnor. Kjo ia shton shumë bukurinë dhe shprehësinë duke siguruar njëkohësisht edhe kuptime të shumta në sa më pak fjalë. Po kështu, Kurani në këtë ajet u quajt *methanije*, “e përsëritur”, që nënkupton se Kurani përshkruan parimet bazë të besimit në mënyrë të përsëritur dhe në forma të ndryshme, që të theksojë rëndësinë, domosdoshmërinë dhe qëllimin e tyre. Kjo fjalë gjithashtu ka kuptimin që disa nga mësimet e Kuranit ngjajnë me ato të Librave të mëparshëm Hyjnorë, mësimet të cilat janë të patjetërsueshme dhe të përsosura në domethëniet e tyre. Për sa i përket ndikimit të Kuranit, ky ajet pohon që lexuesit e tij së pari pushtohen nga madhështia e Zotit të tyre, ndikim i cili pasqyrohet në lëkurat e tyre, dhe më pas ata fillojnë të kenë druajtje ndaj Tij, saqë duke lexuar alarmimet e Tij dhe duke parë shenjat e Madhësisë së Tij, rrëqethen nga frika e mospëlqimit të Tij. Andaj, përpiqen natë e ditë për t'iu nënshtruar Atij. Kur ky nënshtrim u bëhet pjesë e qenies së tyre, lëkurat dhe zemrat e tyre drithërohen, dhe ata me mish e me shpirt jepen pas Zotit në atë mënyrë, që përmendja e Allahut fillon të rrjedhë si ujë në shpirtin e tyre. Atëherë ata zbatojnë çdo porosi Hyjnore me lehtësi, pa pasur asnjë pengesë në kokë dhe pa ndier asnjë barrë në kraharor. Pra, Allahu i Madhërisë ua ndërron tërë frikën dhe të gjitha broughtat me një kënaqësi të veçantë.

30. Allahu dha shembullin e një njeriu që u përket pronarëve të shumtë, të cilët kundërshtojnë njëri-tjetrin, dhe të një njeriu tjetër që i gjithi i përket një njeriu të vetëm. Këta të dy a mund të jenë të barabartë në gjendjen e tyre?! Lavdia është e Allahut. Por në të vërtetë shumica e tyre nuk dinë.<sup>7</sup>

صَرَبَ اللَّهُ مَثَلًا رَجُلًا فِيهِ شُرَكَاءُ  
مُتَشَكِّمُونَ وَرَجُلًا سَلَمًا لِرَجُلٍ هَلْ  
يَسْتَوِينَ مَثَلًا الْحَمْدُ لِلَّهِ بَلْ أَكْثَرُهُمْ  
لَا يَعْلَمُونَ ﴿٣٠﴾

31. Pa dyshim, edhe ti do të vdesësh, edhe ata do të vdesin.

إِنَّكَ مَيِّتٌ وَإِنَّهُمْ مَيِّتُونَ ﴿٣١﴾

32. Më pas, pa dyshim, ju do të grindeni me njëri-tjetrin Ditën e Kiametit pranë Zotit tuaj.

ثُمَّ إِنَّكُمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ عِنْدَ رَبِّكُمْ  
تَخْتَصِمُونَ ﴿٣٢﴾

Xhuzi 24

33. Kush mund të jetë më keqbërës se ai që gënjeu mbi Allahun, dhe quajti gënjeshtër të vërtetën kur ajo i erdhi?! A nuk është në xhehenem streha për mohuesit?!

فَمَنْ أَظْلَمُ مِمَّنْ كَذَبَ عَلَى اللَّهِ  
وَكَذَبَ بِالْصِّدْقِ إِذْ جَاءَهُ أَلَيْسَ فِي  
جَهَنَّمَ مَثْوًى لِّلْكَافِرِينَ ﴿٣٣﴾

34. Kurse ai që erdhi me të vërtetën dhe (ai) që vërtetoi atë, janë të druajturit e vërtetë (ndaj Zotit).

وَالَّذِي جَاءَ بِالصِّدْقِ وَصَدَّقَ بِهِ أُولَٰئِكَ  
هُمْ الْمُتَّقُونَ ﴿٣٤﴾

35. Pranë Zotit ata do të kenë gjithçka që do të kërkojnë; ky është shpërblimi i mirëbërësve;

لَهُمْ مَا يَشَاءُونَ عِنْدَ رَبِّهِمْ ذَٰلِكَ جَزَاؤُ  
الْمُحْسِنِينَ ﴿٣٥﴾

36. që Allahu t'ua largojë veprat më të këqija që ata kishin bërë, e t'u japë shpërblimet e tyre sipas veprave më të mira që ata bënin.

لِيَكْفِرَ اللَّهُ عَنْهُمْ أَسْوَأَ الَّذِي عَمِلُوا  
وَيَجْزِيَهُمْ أَجْرَهُمْ بِأَحْسَنِ الَّذِي كَانُوا  
يَعْمَلُونَ ﴿٣٦﴾

7. Ai që nuk beson në Zotin e Vetëm, i duhet të besojë në shumë zota, qofshin idhuj, qofshin njerëz, qofshin dëshirat vetjake. Kështu, ai është i detyruar t'u shërbejë e t'u nënshtrohet shumë zotave. Fati i tij është për të ardhur keq. A mund të jetë ai si besimtari i vërtetë që punon për të kënaqur vetëm një Zot, Allahun e Madhërisëm?!



37. A nuk i mjafton Allahu rob-it të Vetë?! Ata të frikësojnë me të tjerët përveç Atij. Atë që e cilëson të devijuar Allahu, nuk ka më udhëzues për të.

38. Dhe atë që e udhëzon Allahu, nuk ka më devijues për të. A nuk është Allahu Mbizotërues (dhe) Hakmarrës?!

39. Nëse i pyet: “Kush i krijoi qiejt e tokën?”, ata patjetër do të thonë: “Allahu!”. Thuaju: A keni menduar që nëse Allahu dëshiron të më sjellë ndonjë dëm, a mund ta largojnë dot dëmin e (shkaktuar prej) Tij ata që ju u luteni në vend të Allahut?; ose nëse Ai dëshiron të më bëjë ndonjë mëshirë, a mund ta pengojnë dot ata mëshirën e Tij? Thuaj: Më mjafton Allahu! Tek Ai mbështeten ata që kërkojnë mbështetje.

40. Thuaj: O populli im! Veproni në vendin tuaj, edhe unë do të veproj. Së shpejti do të mësoni,

41. (se) kujt i vjen ndëshkimi që do ta poshtërojë atë, si dhe kujt i bie një ndëshkim që mbetet.

42. Sigurisht, Ne të kemi zbritur Librin me të vërtetën për njerëzit. Ai që udhëzohet, udhëzohet për veten e tij dhe ai që devijon, devijon kundër vetes së tij. Ti nuk je mbikëqyrës për ta.

أَلَيْسَ اللَّهُ بِكَافٍ عَبْدَهُ ۗ وَ يَخَوِّفُونَكَ  
بِالَّذِينَ مِنْ دُونِهِ ۗ وَمَنْ يُضِلِلِ اللَّهُ فَمَا لَهُ  
مِنْ هَادٍ ۝

وَمَنْ يَهْدِ اللَّهُ فَمَا لَهُ مِنْ مُضِلٍّ ۗ أَلَيْسَ  
اللَّهُ بِعَزِيزٍ ذِي انْتِقَامٍ ۝

وَلَيْنَ سَأَلْتَهُمْ مَنْ خَلَقَ السَّمَوَاتِ  
وَالْأَرْضَ لَيَقُولُنَّ اللَّهُ ۗ قُلْ أفرءَيْتُمْ مَا  
تَدْعُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ إِنْ أَرَادَنِيَ اللَّهُ  
بِضَرٍّ هَلْ هُنَّ كَاشِفَاتُ ضَرِّهِ أَوْ أَرَادَنِي  
بِرَحْمَةٍ هَلْ هُنَّ مُمْسِكَتُ رَحْمَتِهِ ۗ قُلْ  
حَسْبِيَ اللَّهُ عَلَيْهِ يَتَوَكَّلُ الْمُتَوَكِّلُونَ ۝

قُلْ يَقَوْمِ اعْمَلُوا عَلَىٰ مَكَانَتِكُمْ إِنِّي  
عَامِلٌ ۚ فَسَوْفَ تَعْلَمُونَ ۝

مَنْ يَأْتِيهِ عَذَابٌ يُغْزِيهِ وَيَحِلُّ عَلَيْهِ  
عَذَابٌ مُّقِيمٌ ۝

إِنَّا أَنْزَلْنَا عَلَيْكَ الْكِتَابَ لِلنَّاسِ بِالْحَقِّ ۗ  
فَمَنْ اهْتَدَىٰ فَلِنَفْسِهِ ۗ وَمَنْ ضَلَّ فَإِنَّمَا  
يُضِلُّ عَلَيْهِمَا ۗ وَمَا أَنْتَ عَلَيْهِمْ بِوَكِيلٍ ۝

43. Allahu merr shpirtrat në kohën e vdekjes së tyre, dhe ato që nuk vdesin, (i merr) në gjumin e tyre. Më pas, i mban ato për të cilat vendos vdekjen, dhe të tjerat i dërgon (sërisht) për një afat të caktuar. Pa dyshim, në këtë ka shenja për njerëzit që meditojnë.<sup>8</sup>

44. A kanë zgjedhur ndërmjetësues të tjerë duke e lënë Allahun?! Thuaj: Edhe sikur ata nuk zotërojnë asgjë dhe as nuk kuptojnë?!

45. Thuaj: (Çështja e) ndërmjetësimit e gjitha i takon Allahut. I Atij është sundimi i qiejve dhe i tokës. Më pas, tek Ai do të ktheheni ju.

46. Kur ua përmend Allahun e Vetëm atyre që nuk besojnë në *ahiret*, u pushtohen zemrat nga urrejtja, dhe kur u përmend të tjerët përveç Atij, gëzohen shumë.

47. Thuaj: O Allah, Krijuesi i qiejve dhe i tokës, i Dijshmi i së padukshmes dhe i së dukshmes! Ti gjykon mes robërve të Tu në atë që ata kundërshtojnë!

48. Ata që janë keqbërës edhe sikur të kenë gjithçka që ka toka dhe po aq si shtesë, do ta jepnin që të shlyheshin përmes saj për të shpëtuar nga ndëshkimi më i keq në Ditën e Kiametit. Prej Allahut atyre do t'u zbulohet ajo që ata as nuk e imagjinonin.

اللَّهُ يَتَوَفَّى الْأَنْفُسَ حِينَ مَوْتِهَا وَالَّتِي لَمْ تَمُتْ فِي مَمَاتِهَا<sup>٤٣</sup> فِيمَسِكُ الَّتِي قَضَىٰ عَلَيْهَا الْمَوْتَ وَيُرْسِلُ الْأُخْرَىٰ إِلَىٰ أَجَلٍ مُّسَيَّءٍ<sup>٤٤</sup> إِنَّ فِي ذَٰلِكَ لَآيَاتٍ لِّقَوْمٍ يَتَفَكَّرُونَ<sup>٤٥</sup>

أَمْ اتَّخَذُوا مِنْ دُونِ اللَّهِ شُفَعَاءَ<sup>٤٦</sup> قُلْ أَوْلُواكَأُولَآئِمْ لِكُونَ شَيْئًا وَلَا يَعْقِلُونَ<sup>٤٧</sup>

قُلْ لِلَّهِ الشَّفَاعَةُ جَمِيعًا<sup>٤٨</sup> لَهُ مُلْكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ<sup>٤٩</sup> ثُمَّ إِلَيْهِ تُرْجَعُونَ<sup>٥٠</sup>

وَإِذَا ذُكِرَ اللَّهُ وَحْدَهُ اشْمَأَزَّتْ قُلُوبُ الَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ بِالْآخِرَةِ<sup>٥١</sup> وَإِذَا ذُكِرَ الَّذِينَ مِنْ دُونِهِ إِذَا هُمْ يَسْتَبْشِرُونَ<sup>٥٢</sup>

قُلِ اللَّهُمَّ فَاطِرَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ عَلِمَ الْغَيْبِ وَالشَّهَادَةِ أَنْتَ تَحْكُمُ بَيْنَ عِبَادِكَ فِي مَا كَانُوا فِيهِ يَخْتَلِفُونَ<sup>٥٣</sup>

وَلَوْ أَنَّ لِلَّذِينَ ظَلَمُوا مَا فِي الْأَرْضِ جَمِيعًا وَ مِثْلَهُ مَعَهُ لَافْتَدَوْا بِهِ مِنْ سُوءِ الْعَذَابِ يَوْمَ الْقِيَامَةِ<sup>٥٤</sup> وَ بَدَأَ لَهُمْ مِنَ اللَّهِ مَا لَمْ يَكُونُوا يَحْتَسِبُونَ<sup>٥٥</sup>

8. Lexoni një shpjegim shkencor në parathënien e sures.

49. Dhe prej Allahut atyre do t'u zbulohen të këqijat e gjithë asaj që ata punuan dhe do t'i rrethojë ajo që ata përqeshnin.

وَبَدَا لَهُمْ سَيِّئَاتُ مَا كَسَبُوا وَحَاقَ بِهِمْ  
مَا كَانُوا بِهِ يَسْتَهْزِءُونَ ﴿٤٩﴾

50. Kur njeriun e prek ndonjë vështirësi, Na lutet Neve, më pas kur Ne i dhurojmë prej Vetes një bekim, ai thotë: “Kjo më është dhënë mua, me siguri për shkak të një dijeje (që zotëroj)!” Përkundrazi, ajo është një sprovë, por shumica e tyre nuk dinë.

فَإِذَا مَسَّ الْإِنْسَانَ ضُرٌّ دَعَانَا ثُمَّ إِذَا  
خَوَّلْنَاهُ نِعْمَةً مِّثْلًا قَالِ إِنَّمَا أُوتِيتُهُ عَلَى  
عِلْمٍ ۗ بَلْ هِيَ فِتْنَةٌ وَلَكِنَّ أَكْثَرَهُمْ لَا  
يَعْلَمُونَ ﴿٥٠﴾

51. Pikërisht kështu thanë ata që ishin para tyre, por nuk u vlejti dot ajo që ata punonin.

قَدْ قَالُوا الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ فَمَا أَعْنَى  
عَنَّهُمْ مَا كَانُوا يَكْسِبُونَ ﴿٥١﴾

52. I goditën të këqijat e asaj që ata punuan. Dhe edhe prej këtyre, ata që janë keqberës do t'i godasin të këqijat që ata punuan. Ata nuk mund ta mposhtin dot (Allahun).

فَأَصَابَهُمْ سَيِّئَاتُ مَا كَسَبُوا ۗ وَالَّذِينَ  
ظَلَمُوا مِنْ هَؤُلَاءِ سَيُصِيبُهُمْ سَيِّئَاتُ مَا  
كَسَبُوا ۗ وَمَاهُمْ بِمُعْجِزِينَ ﴿٥٢﴾

53. A nuk e dinë se Allahu ia shton të mirat kujt të dojë, dhe (edhe) ia pakëson. Pa dyshim, në këtë ka shenja për njerëzit që besojnë.

أَوَلَمْ يَعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ يَبْسُطُ الرِّزْقَ لِمَنْ  
يَشَاءُ وَيَقْدِرُ ۗ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِّقَوْمٍ  
يُؤْمِنُونَ ﴿٥٣﴾

54. Thuaj: O robërit e Mi që keqtrajtuat veten tuaj! Mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Sigurisht, Allahu fal të gjitha mëkatet. Sigurisht, Ai është Falësi, Mëshirëbërësi.<sup>9</sup>

قُلْ لِعِبَادِيَ الَّذِينَ أَسْرَفُوا عَلَىٰ أَنفُسِهِمْ  
لَا تَقْنَطُوا مِنْ رَحْمَةِ اللَّهِ ۗ إِنَّ اللَّهَ يَغْفِرُ  
الدُّنُوبَ جَمِيعًا ۗ إِنَّهُ هُوَ الْغَفُورُ  
الرَّحِيمُ ﴿٥٤﴾

9. Ky ajet jep një mesazh shprese, u jep optimizëm mëkatarëve dhe ua largon dëshpërimin. Kurani e dënon pesimizmin dhe dëshpërimin dhe thotë se vetëm mohuesit e Zotit mund të dëshpërohen (12:88). Kurani vazhdimisht ua jep njerëzve mesazhin e mëshirës dhe të faljes prej Zotit (6:55; 7:157; 12:88; 15:57; 18:59). Një kuptim tjetër i këtij ajeti është që Zoti e urdhëron Profetin Muhammed<sup>savs</sup> që të njoftojë: “O robërit e mi!” dhe nëse përemri i referohet Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, fjala *robër* ka kuptimin e *shërbëtorëve*. Dhe domethënia e ajetit është

55. Dhe përuluni te Zoti juaj dhe nënshtrojuni Atij përpara se t'ju vijë ndëshkimi, (sepse) më pas, nuk do të ndihmoheni.<sup>10</sup>

وَأَنِيبُوا إِلَىٰ رَبِّكُمْ وَأَسْلُمُوا لَهُ مِنْ قَبْلِ  
أَنْ يَأْتِيَكُمُ الْعَذَابُ ثُمَّ لَا تُنصَرُونَ ﴿٥٥﴾

56. Dhe ndiqni më të bukurën e asaj që ju është zbritur prej Zotit tuaj përpara se t'ju vijë befasi ndëshkimi, kur ju të jeni të pavetëdijshëm.

وَاتَّبِعُوا أَحْسَنَ مَا أُنزِلَ إِلَيْكُمْ مِنْ رَبِّكُمْ  
مِنْ قَبْلِ أَنْ يَأْتِيَكُمُ الْعَذَابُ بَغْتَةً وَ أَنْتُمْ  
لَا تَشْعُرُونَ ﴿٥٦﴾

57. Të mos thotë njeri: “Mjerë unë për shkeljet që kam bërë para Allahut, madje kam qenë ndër ata që përqeshnin!”

أَنْ تَقُولَ نَفْسٌ يُحْصِرُنِي عَلَىٰ مَا فَرَّطْتُ  
فِي جَنْبِ اللَّهِ وَإِنْ كُنْتُ لَمِنَ السَّخِرِينَ ﴿٥٧﴾

58. Ose të thotë: “Po të më udhëzonte Allahu, unë patjetër do të bëhesha ndër të druajturit (ndaj Tij).”

أَوْ تَقُولَ لَوْ أَنَّ اللَّهَ هَدَانِي لَكُنْتُ مِنَ  
الْمُتَّقِينَ ﴿٥٨﴾

59. Ose të thotë në momentin kur të shikojë ndëshkimin: “Sikur të kisha një kthim, patjetër do të bëhesha ndër mirëbërësit!”

أَوْ تَقُولَ حِينَ تَرَىٰ الْعَذَابَ لَوْ أَنَّ لِي كَرَّةً  
فَأَكُونُ مِنَ الْمُحْسِنِينَ ﴿٥٩﴾

60. “Po si?! Ty të erdhën shenjat e Mia dhe ti i quajte gënjeshtër, u tregove mendjemadh dhe ishe ndër mohuesit!”

بَلَىٰ قَدْ جَاءَ نَكَ أُمَّي فَاكَدَّبَتْ بِهَا  
وَاسْتَكْبَرَتْ وَكُنْتَ مِنَ الْكٰفِرِينَ ﴿٦٠﴾

61. Dhe Ditën e Kiametit do t'i shohësh ata që gënjen mbi Allahun, që do t'u nxihen fytyrat. Streha e mendjemëdhenjve a nuk është në xhehenem?!

وَ يَوْمَ الْقِيَامَةِ تَرَىٰ الَّذِينَ كَذَبُوا عَلَىٰ اللَّهِ  
وُجُوهُهُم مُّسْوَدَّةٌ ۗ أَلَيْسَ فِي جَهَنَّمَ مَثْوًى  
لِّلْمُتَكَبِّرِينَ ﴿٦١﴾

që nëse bëhesh ndjekës dhe shërbëtor i sinqertë i Profetit Muhammed<sup>saws</sup>, Zoti do të të falë ty të gjitha mëkatet. Kjo përmendet me temën e dashurisë në 3:32.

10. Ndërsa ajeti i mëparshëm u jep mëkatarëve mesazhin dhe shpresën se ata mund të dalin nga mëkatet e tyre, ky ajete edhe i paralajmëron se vetë atyre do t'u duhet ta zgjedhin këtë mundësi, duke iu nënshtuar porosive Hyjnore.

62. Dhe ata që patën druajtje (ndaj Allahut), Allahu do t'i shpëtojë (duke i nderuar) për sukseset e tyre; e keqja nuk do t'i prekë ata dhe as nuk do të brengosen.

63. Allahu është Krijuesi i çdo gjëje dhe Ai është Mbrojtës mbi çdo gjë.

64. Ai i ka çelësat e qiejve e të tokës. Dhe ata që mohuan shenjat e Allahut, do të jenë humbësit.

65. Thuaj: “A më urdhëroni të adhuroj tjetërkënd (dhe) jo Allahun, o injorantë?!”

66. Kurse ty t'u shpall, si dhe atyre që ishin para teje: Nëse do të adhurosh tjetërkënd, patjetër që do të zhvlerësohet vepra jote dhe do të bëhesh ndër të humburit.

67. Prandaj, Allahun adhuroje dhe bëhu ndër mirënjohësit!

68. Dhe ata nuk e vlerësuan Allahun siç duhet vlerësuar Ai. Toka e gjitha do të jetë nën pushtetin e Tij Ditën e Kiametit, dhe qiejt do të jenë të palosura në Dorën e Tij të djathtë.<sup>11</sup> I Pastër është Allahu dhe shumë i lartë nga ato që ata i bëjnë ortakë (me Të).

11. Ky ajet jep një skicë të kiametit duke thënë: (1) Toka e gjitha do të jetë nën pushtetin e Allahut të Madhërishëm, dhe (2) Qiejt, pra i gjithë universi, do të jetë i palosur në Dorën e Tij të djathtë. Dora e djathtë nënkupton dorën e fuqisë e jo ndonjë dorë fizike. Për sa i përket palosjes së universit, në kohën tonë teoritë shkencore tanimë e kanë provuar se kështu do të ngjajë. Pra, sipas tyre, universi do të asgjësohet duke hyrë në një vrimë të zezë në atë mënyrë, sikur të jetë duke u palosur rreth saj. Ajete të tjera të Kuranit Famëlartë shpjegojnë edhe më tej se çfarë do të thotë kjo palosje. Lexoni 21:105.

وَيَجِيءُ اللَّهُ الَّذِينَ اتَّقَوْا بِمَفَازَتِهِمْ  
لَا يَمَسُّهُمُ السُّوءُ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ ﴿٦٢﴾

اللَّهُ خَالِقُ كُلِّ شَيْءٍ ۖ وَهُوَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ  
وَكَيِّنٌ ﴿٦٣﴾

لَهُ مَقَالِيدُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ۗ وَالَّذِينَ  
بَغَوْا كَفَرُوا بِآيَاتِ اللَّهِ أُولَٰئِكَ هُمُ الْخَاسِرُونَ ﴿٦٤﴾

قُلْ أَفَعَيَّرَ اللَّهُ تَأْمُرُونَني أَعْبُدُ أَيَّهَا  
الْجَاهِلُونَ ﴿٦٥﴾

وَلَقَدْ أَوْحَىٰ إِلَيْكَ وَإِلَى الَّذِينَ مِنْ قَبْلِكَ  
لَئِنْ أَشْرَكْتَ لَيَحْبَطَنَّ عَمَلُكَ وَلَتَكُونَنَّ  
مِنَ الْخَاسِرِينَ ﴿٦٦﴾

بِاللَّهِ فَاعْبُدْهُ وَكُنْ مِنَ الشَّاكِرِينَ ﴿٦٧﴾

وَمَا قَدَرُوا اللَّهَ حَقَّ قَدْرِهِ ۗ وَالْأَرْضُ  
جَمِيعًا قَبْضَتُهُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ وَالسَّمَوَاتُ  
مَطْوِيَّاتٍ بِيَمِينِهِ ۗ سُبْحٰنَهُ وَتَعَالَىٰ عَمَّا  
يُشْرِكُونَ ﴿٦٨﴾

69. Dhe do t'i fryhet bririt, atëherë kushdo që është nëpër qiej dhe kushdo që është në tokë do të bjerë pa ndjenja, përveç atij që do Allahu. Më pas do t'i fryhet (bririt) edhe një herë tjetër, dhe ja, ata do të jenë në këmbë duke parë.

70. Dhe toka do të ndriçohet me dritën e Zotit të saj, do të vendoset Libri, do të sillen profetët e dëshmitarët, do të vendoset mes tyre me drejtësi dhe atyre nuk do t'u bëhet padrejtësi.

71. Dhe çdo shpirti do t'i jepet plotësisht shpërblimi i asaj që ka punuar dhe Ai e di më së miri se çfarë kanë bërë ata.

72. Dhe ata që mohuan do të shtyhen grupe-grupe drejt xhehenemit, derisa kur do të mbërrijnë tek ai, do të hapen portat e tij, dhe rojet e tij do t'u thonë: “A nuk ju kishin ardhur të dërguar nga gjiri juaj, që ju lexonin ajetet e Zotit tuaj dhe ju paralajmëronin për takimin tuaj të kësaj dite?” Ata do të thonë: “Patjetër që po, por doli e vërtetë fjala për ndëshkimin e mohuesve.”

73. Do t'u thuhet: “Hyni në portat e xhehenemit, ku do të jetoni gjatë! Sa e keqe është streha për mendjemëdhenjtë!

74. Dhe ata që patën druajtje ndaj Zotit të tyre do të shtyhen grupe-grupe drejt xhenetit, derisa kur do të

وَنُفِخَ فِي الصُّورِ فَصَعِقَ مَنْ فِي السَّمَوَاتِ  
وَمَنْ فِي الْأَرْضِ إِلَّا مَنْ شَاءَ اللَّهُ ثُمَّ  
نُفِخَ فِيهِ أُخْرَىٰ فَإِذَا هُمْ قِيَامٌ  
يَنْظُرُونَ ﴿٦٩﴾

وَأَشْرَقَتِ الْأَرْضُ بِنُورِ رَبِّهَا وَوُضِعَ  
الْكِتَابُ وَجَاءَتِ الْبَلْبَيْنِ وَالشُّهَدَاءُ  
وَقُضِيَ بَيْنَهُم بِالْحَقِّ وَهُمْ لَا يُظْلَمُونَ ﴿٧٠﴾

وَوُفِّيَتْ كُلُّ نَفْسٍ مَّا عَمِلَتْ وَهُوَ أَعْلَمُ  
بِمَا يَفْعَلُونَ ﴿٧١﴾

وَسَيِّقَ الَّذِينَ كَفَرُوا إِلَىٰ جَهَنَّمَ زُرًّا  
حَتَّىٰ إِذَا جَاءُوهَا فَتِحَتْ أَبْوَابُهَا وَقَالَ  
لَهُمْ خَزَنَتُهَا أَلَمْ يَأْتِكُمْ رُسُلٌ مِّنكُمْ  
يَتْلُونَ عَلَيْكُمْ آيَاتِ رَبِّكُمْ وَيُنذِرُونَكُمْ  
لِقَاءِ يَوْمِكُمْ هَذَا قَالُوا بَلَىٰ وَلَكِنْ  
حَقَّتْ كَلِمَةُ الْعَذَابِ عَلَى الْكَافِرِينَ ﴿٧٢﴾

قِيلَ ادْخُلُوا أَبْوَابَ جَهَنَّمَ خَالِدِينَ فِيهَا  
فَإِنَّ مَثْوَى الْمُتَكَبِّرِينَ ﴿٧٣﴾

وَسَيِّقَ الَّذِينَ اتَّقَوْا رَبَّهُمْ إِلَى الْجَنَّةِ  
زُرًّا حَتَّىٰ إِذَا جَاءُوهَا وَفُتِحَتْ أَبْوَابُهَا

mbërrijnë tek ai, do të hapen portat e tij dhe rojet e tij do t'u thonë: “Paqe qoftë mbi ju! Jeni të mbarë! Hyni në të për të jetuar përgjithmonë!”

75. Ata do të thonë: “Lavdia është e Allahut që na e plotësoi premtimin e Tij dhe na trashëgoi tokën (e premtuar); në xhenet mund të zgjedhim vendin ku të duam. Sa i mbarë është shpërblimi për punëtorët!

76. Dhe do të shohësh engjëjt të rreshtuar përreth Arshit, duke përkujtuar Zotin e tyre me lavdërimin e Tij. Do të vendoset mes tyre me drejtësi dhe do të thuhet: Lavdia është e Allahut, Zotit të botëve.

وَقَالَ لَهُمْ خَزَنَتُهَا سَلِّمْ عَلَيْكُمْ طِبْتُمْ  
فَادْخُلُوهَا خَالِدِينَ ﴿٧٥﴾

وَقَالُوا الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي صَدَقَنَا وَعْدَهُ  
وَأَوْرَثَنَا الْأَرْضَ نَتَبَوَّأُ مِنَ الْجَنَّةِ حَيْثُ  
نَشَاءُ ۖ فَنِعْمَ أَجْرُ الْعَمِلِينَ ﴿٧٦﴾

وَتَرَى الْمَلَائِكَةَ حَافِّينَ مِنْ حَوْلِ الْعَرْشِ  
يُسَبِّحُونَ بِحَمْدِ رَبِّهِمْ ۗ وَقُضِيَ بَيْنَهُمْ  
بِالْحَقِّ وَقِيلَ الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿٧٧﴾

## Surja 40 – El-Mu'min

Surja El-Mu'min [që quhet edhe El-Gafir] është mekase dhe, bashkë me *bismillahin*, ka tetëdhjetë e gjashtë ajete.

Kjo sure fillon me shkurtesat *Ha.Mim.*, dhe pas kësaj, edhe gjashtë sure të tjera me radhë fillojnë po me këto shkurtesa. Pra, gjithsej shtatë sure njëra pas tjetrës fillojnë me shkurtesat *Ha.Mim.*. Allahu e di më mirë se çfarë lidhje mund të kenë këto sure me suren El-Fatiha që ka shtatë ajete.

Në suren paraardhëse, Allahu i Madhërishëm i tha njerëzimit – Mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Humbja e shpresës ose dëshpërimi, në të vërtetë, është veti e djallit. Kurse ai që me zemër të sinqertë mbështetet te mëshira e Allahut, bën edhe pendesën e sinqertë nga mëkatet e tij, Allahu i Madhërishëm ka fuqi t'ia falë të gjitha mëkatet.

Po kështu, surja e mëparshme tregon një veti të engjëjve duke thënë se ata qëndrojnë rreth *Arshit* (Fronit), por kjo sure shton më tej dhe u thotë njerëzve se falja e mëkateve të tyre ka një lidhje edhe me lutjet e engjëjve, të cilët e kanë mbajtur Arshin e Allahut. Natyrisht, Allahu nuk është si diçka fizike, që të ulet fizikisht në ndonjë arsh a fron, të cilin engjëjve do t'u duhej ta mbanin. Allahu gjendet gjithkund dhe Ai ka mbajtur në këmbë çdo gjë të universit. Prandaj, mendoj se këtu janë përmendur atributet e qenësishme, pra ekskluzive, të Zotit (*sifat tenzihije*), kurse Arshi nënkupton zemrën e pastër të Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, sepse ajo praktikisht u shndërrua në fronin e Allahut. Engjëjt ia rrethuan zemrën për ta përforcuar atë dhe ata edhe luten për robërit gjynahqarë të Allahut dhe për pasardhësit e tyre. Prandaj, unë besoj me bindje se lutjet që kanë dalë nga Arshi i vendosur në zemrën e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, do të jenë në dobi të robërve të sinqertë dhe të pasardhësve të tyre deri në Ditën e Kiametit.

Po në këtë sure përmendet një princ i oborrit të Faraonit, i cili kishte pranuar Hazret Musain<sup>as</sup> si të dërguar të Zotit, por e fshihte besimin e tij. Megjithatë, kur pa që Faraoni po ngrinte kurth për ta vrarë Hazret Musain<sup>as</sup>, nuk heshti dot dhe i bëri një paralajmërim të fuqishëm popullit të vet duke thënë – *Nëse Musai është gënjeshtar, lëreni atë, sepse do të shkatërrohet vetë, por nëse ai është i Dërguar i vërtetë, do t'ju godasin patjetër disa nga ato që ai ju ka paralajmëruar.*

Ajetet që flasin për ngjarjen e mësipërme, udhëzojnë të gjithë njerëzit që çështjen e pretenduesit të profetërisë, pra, të atij që deklaroi të jetë profet ose i dërguar i Zotit, t'ia lënë Zotit të Madhërishëm. Sepse, nëse ai është gënjeshtar, Zoti Vetë do ta shkatërrojë atë; por nga ana tjetër, nëse ai vërtet është i dërguar prej Zotit, disa nga paralajmërimet e tij do t'i godasin patjetër ata që e kanë mohuar atë. Ngaqë këto ajete lidhen edhe me ata që kanë deklaruar të ishin profetë pas Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, historia është dëshmitare që ata janë trajtuar sipas kriterit që u përmend më lart. Ata pretendues të profetërisë që ishin gënjeshtarë, që të gjithë u shkatërruan.



Në vazhdë të kësaj teme, u cek gjithashtu deklarata e njerëzve të kohës së *Hazret Jusufit*<sup>as</sup>, të cilët thoshin se nuk duhej të kishte profet pas *Hazret Jusufit*<sup>as</sup>. Po të ishte i vërtetë mendimi i tyre, si mund të vinte vetë Profeti Muhammed<sup>savs</sup>?! Prandaj, këto janë pretendime të atyre njerëzve që nuk kanë dije rreth caktimit të Allahut. Çdo gjë mund të mbyllet, por rruga e bekimeve të Zotit nuk mund të mbyllet. Duke vijuar të njëjtën temë, kjo sure në njëërën anë pohoi që Zoti i shkatërron “profetët” e rremë, nga ana tjetër deklaroi se Ai patjetër i ndihmon Profetët e vërtetë, dhe i sfidon kundërshtarët duke thënë – *Bëni gjithçka që mundeni, por kurrësi nuk mund t'i mundni Profetët e vërtetë të Allahut të Madhërishëm!*

Ajeti nr. 66 edhe njëherë na porositi [sikurse në suren paraardhëse] t'ia përkushtojmë fenë vetëm Allahut dhe se përveç Zotit të Gjallë, zot tjetër nuk ka: *“Ai është i Gjalli, nuk ka të adhurueshëm tjetër përveç Atij, andaj, Atij lutjuni duke ia përkushtuar fenë vetëm Atij.”*

Ajetet:  
86٤٠ سُورَةُ الْمُؤْمِنِينَ  
40. EL-MU'MIN  
MekaseRukatë:  
9

1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. *Ha.Mim.* (I Lavdishëm, i Nde-ruar.)

حَمِّمٌ ①

3. Zbritja e Librit është prej Allahut, të Gjithëfuqishmit, të Gjithëdijshtimit;

تَنْزِيلُ الْكِتَابِ مِنَ اللَّهِ الْعَزِيزِ الْعَلِيمِ ①

4. Falësit të mëkateve, Pranuesit të pendesës, të Fortit në ndëshkim, Dhuruesit të madh; Nuk ka të adhurueshëm tjetër përveç Atij; tek Ai është kthimi.

عَافِرِ الذَّنْبِ وَقَابِلِ التَّوْبِ شَدِيدِ الْعِقَابِ ذِي الطَّوْلِ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ إِلَيْهِ الْمَصِيرُ ①

5. Askush nuk lufton me shenjzat e Allahut përveç atyre që mohuan. Andaj, nuk duhet të të mashtrojë ty bredhja e tyre nëpër qytete.<sup>1</sup>

مَا يَجَادِلُ فِي آيَاتِ اللَّهِ إِلَّا الَّذِينَ كَفَرُوا فَلَا يَعْرُزُكَ تَقْلُبُهُمْ فِي الْبِلَادِ ①

6. Para tyre përgënjeshtroan edhe populli i Nuhut, dhe pas tyre edhe grupe të ndryshme. Çdo popull vendosi në lidhje me të Dërguarin e vet që ta kapnin atë, dhe luftuan me anë të gënjeshtres që ta kundërshtonin të vërtetën. Atëherë Unë i kapa. (Shikoni se) si ishte ndëshkimi Im!

كَذَّبَتْ قَبْلَهُمْ قَوْمُ نُوحٍ وَالْأَحْزَابُ مِنْ بَعْدِهِمْ وَهَمَّتْ كُلُّ أُمَّةٍ بِرَسُولِهِمْ لِيَأْخُذُوهُ وَجَدُوا بِالْبَاطِلِ لِيُدْحِضُوا بِهِ الْحَقَّ فَأَخَذْتُهُمْ فَكَيْفَ كَانَ عِقَابِ ①

7. Dhe kështu u vërtetua fjala e Zotit tënd për ata që mohuan se janë banorët e zjarrit.

وَكَذَلِكَ حَقَّتْ كَلِمَتُ رَبِّكَ عَلَى الَّذِينَ كَفَرُوا أَنَّهُمْ أَصْحَابُ النَّارِ ①

وَقَدْ أَهْلَكْنَا  
الْبِلَادَ  
الَّتِي كَانَتْ  
عَلَيْهَا

1. Besimtarëve u thuhet të mos mashtrohen duke parë shkëlqimin material të jobesimtarëve, pasi në një kohë afatgjate shkëlqimi i tyre do të rezultojë vetëm në humbje.

8. Ata që e mbajnë Arshin dhe ata që janë rreth tij, përkujtojnë Zotin e tyre me lavdinë e Tij, e besojnë Atë dhe kërkojnë falje për ata që besuan: “O Zoti ynë! Ti sundon çdo gjë me mëshirë dhe dije. Andaj, fali ata që u penduan dhe ndoqën rrugën Tënde, dhe shpëtoji nga ndëshkimi i xhehenemit!

الَّذِينَ يَحْمِلُونَ الْعَرْشَ وَمَنْ حَوْلَهُ  
يُسَبِّحُونَ بِحَمْدِ رَبِّهِمْ وَيُؤْمِنُونَ بِهِ  
وَيَسْتَغْفِرُونَ لِلَّذِينَ آمَنُوا رَبَّنَا وَسِعْتَ  
كُلَّ شَيْءٍ رَحْمَةً وَعِلْمًا فَاغْفِرْ لِلَّذِينَ  
تَابُوا وَاتَّبَعُوا سَبِيلَكَ وَقِهِمْ عَذَابَ  
الْجَحِيمِ ①

9. Dhe, o Zoti ynë, në kopshtet e përjetshme që ua ke premtuar, pranoji ata dhe këdo që u pastrua ndër etërit, bashkëshortët dhe fëmijët e tyre! Ti me të vërtetë je i Plotfuqishmi, i Urti!<sup>2</sup>

رَبَّنَا وَأَدْخِلْهُمْ جَنَّاتٍ عَدْنٍ الَّتِي وَعَدْتَهُمْ  
وَمَنْ صَلَحَ مِنْ آبَائِهِمْ وَأَزْوَاجِهِمْ  
وَدُرِّسَتِهِمْ ② إِنَّكَ أَنْتَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ③

10. Dhe shpëtoji nga ligësitë! Atë ditë, këdo që shpëtove prej (pasojave të) ligësive, e ke mëshiruar. Ky pikërisht është sukcesi madhështor!”

وَقِهِمُ السَّيِّئَاتِ ④ وَمَنْ تَقِ السَّيِّئَاتِ يَوْمَئِذٍ  
بُعْدٌ فَقَدْ رَحِمْتَهُ ⑤ وَذَلِكَ هُوَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ ⑥

11. Pa dyshim, ata që mohuan do të njoftohen: Pakënaqësia e Allahut ishte më e madhe sesa pakënaqësia juaj me njëri-tjetrin; kur juve ju bëhej ftesa drejt besimit, e refuzonit.

إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا يَأْتُوا لَمَقَّةً اللَّهُ أَكْبَرُ  
مِنْ مَقَّتِكُمْ أَنْفُسَكُمْ إِذْ تُدْعَوْنَ إِلَى  
الْإِيمَانِ فَكَفَرْتُمْ ⑦

12. Ata do të thonë: “O Zoti ynë! Na dhe vdekje dy herë dhe na ke ringjallur dy herë, andaj, ne pranojmë mëkatet tona. A ka ndonjë rrugëdalje?”<sup>3</sup>

قَالُوا رَبَّنَا آمَنَّا أَشْتَتَيْنِ وَأَحْيَيْتَنَا أَشْتَتَيْنِ  
فَاعْتَرَفْنَا بِذُنُوبِنَا فَهَلْ إِلَى خُرُوجٍ مِنْ  
سَبِيلٍ ⑧

2. Ajeti parashtron një parim të artë. Nuk mund të kryesh punë të mëdha dhe nuk mund të arrish suksese të mëdha duke qenë i vetëm. Në suksesin e një njeriu kanë kontribut edhe persona të tjerë, në mënyrë të vetëdijshme ose të pavetëdijshme. Këta ndihmës janë kryesisht prindërit, gruaja, fëmijët, shokët etj.. Prandaj, kjo lutje i përfshin edhe anëtarët e familjes në shpërblimin e veprave. Gjithashtu, ky ajet na nxit për të punuar edhe për edukimin fetar dhe moral të familjes, që të gjithë anëtarët e familjes të bëhen ndihmës për njëri-tjetrin në rrugën e besimit.

3. Dy jetë të njeriut kuptohen, njëra kjo jetë e dynjasë dhe tjetra ajo e *ahiretit*. Por vdekja

13. Kjo ju ndodhi për shkak se kurdoherë i bëhej lutje Allahut të Vetëm, ju (e) mohonit dhe, nëse dikush i shtonte ortakë Atij, (e) pranonit. Vendimi i takon Allahut, të Lartit, të Madhit.

ذِكْمُ يَاقُوتَةَ إِذَا دَعَى اللَّهَ وَحْدَهُ كَفَرْتُمْ ۚ  
وَأَنْ يُشْرِكَ بِهِ تَوَمَّنُوا ۗ قَالَ حُكْمُ اللَّهِ  
الْعَلِيِّ الْكَبِيرِ ۝

14. Është Ai që ju tregon shenjat e Tij dhe ju zbret të mira prej qiellit. Nuk merr mësim, përveçse ai që përulet.<sup>4</sup>

هُوَ الَّذِي يُرِيكُمْ آيَاتِهِ وَيُنزِلُ لَكُمْ مِنَ  
السَّمَاءِ رِزْقًا وَمَا يَذَّكَّرُ إِلَّا مَنْ يُنِيبُ ۝

15. Andaj, lutjuni Allahut duke ia përkushtuar fenë vetëm Atij, edhe nëse mohuesve nuk u pëlqen.

فَادْعُوا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ وَلَوْ كَرِهَ  
الْكَافِرُونَ ۝

16. Ai është Ngritësi i gradave, Zotëruesi i Arshit. Ai zbret Shpirtin me urdhrin e Tij mbi kë të dojë prej robërve të Tij, që ai të paralajmërojë për ditën e takimit.<sup>5</sup>

رَفِيعَ الدَّرَجَاتِ ذُو الْعَرْشِ ۚ يُلْقِي  
الرُّوحَ مِنْ أَمْرِهِ عَلَى مَنْ يَشَاءُ مِنْ عِبَادِهِ  
لِيُنذِرَ يَوْمَ التَّلَاقِ ۝

17. Ditën kur ata do të dalin, gjendja e tyre nuk do t'i fshihet Allahut aspak. Kujt i përket sundimi sot? Allahut, të Vetmit, Triumfuesit.

يَوْمَ هُمْ بَارُزُونَ ۗ لَا يَخْفَى عَلَى اللَّهِ مِنْهُمْ  
شَيْءٌ ۗ لِمَنِ الْمُلْكُ الْيَوْمَ ۗ لِلَّهِ الْوَاحِدِ  
الْقَهَّارِ ۝

18. Sot çdo shpirt do të shpërblehet për gjithçka që ka punuar. Sot nuk ka asnjë padrejtësi. Pa dyshim, Allahu është i shpejtë në llogari.

أَلْيَوْمَ تُجْرَى كُلُّ نَفْسٍ بِمَا كَسَبَتْ ۗ لَا  
ظُلْمَ الْيَوْمَ ۗ إِنَّ اللَّهَ سَرِيعُ الْحِسَابِ ۝

në dukje i vjen një herë, kurse ajeti i Kuranit flet për dy vdekje. Vdekja e parë me sa duket nënkupton gjendjen e mosekzistencës përpara lindjes sonë.

4. I gjithë furnizimi, shpirtëror dhe lëndor, zbret nga qielli. Uji, nga i cili varet e gjithë jeta (21:31), zbret nga qielli, dhe po ashtu prej qiellit zbret edhe shpallja ose zbulesa, nga e cila varet jeta shpirtërore e njeriut.

5. Shpirti nënkupton Fjalën e Zotit, të cilën duke e zbatuar të vdekurit shpirtërorë ringjallen. Madje, Zoti edhe Profetët dhe engjëjt i ka quajtur Shpirt, sepse ata janë shkak i asaj jete që quhet besim.

19. Alarmoji ata nga dita që është afruar, kur zemrat do të vijnë në fyt nga frika; keqbërësit nuk do të kenë asnjë shok dhe as ndonjë ndërmjetës që i dëgjohet fjala.

وَأَنْذَرَهُمْ يَوْمَ الْأَرْفَةِ إِذَا انْقَلَبَ  
لَدَى الْحَاجِرِ كُظْمَيْنٌ ۗ مَا لِلظَّالِمِينَ  
مِنْ حَمِيمٍ وَلَا شَفِيعٍ يُطَاعُ ﴿١٩﴾

20. Ai e di edhe tradhtinë e syve, edhe atë që fshehin kraharorët.

يَعْلَمُ خَائِنَةَ الْأَعْيُنِ وَمَا تُخْفِي  
الصُّدُورُ ﴿٢٠﴾

21. Allahu vendos me drejtësi. Kurse ata, të cilëve (njerëzit) u luten, nuk vendosin për asgjë. Pikërisht, Allahu është Gjithëdëgjuesi, Gjithëshikuesi.

وَاللَّهُ يَقْضِي بِالْحَقِّ ۗ وَالَّذِينَ يَدْعُونَ مِنْ  
دُونِهِ لَا يَقْضُونَ بِشَيْءٍ ۗ إِنَّ اللَّهَ هُوَ  
السَّمِيعُ الْبَصِيرُ ﴿٢١﴾

22. A nuk shëtitën ata në tokë që të shihnin si qe fundi i atyre që ishin para tyre?! Ishin më të fortë se këta për sa i përket fuqisë dhe lënies së gjurmëve në tokë. Allahu i kapi edhe ata për mëkatet e tyre dhe ata nuk kanë pasur asnjë shpëtimtar përballë Allahut.

أَوَلَمْ يَسِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَيَنْظُرُوا كَيْفَ  
كَانَ عَاقِبَةُ الَّذِينَ كَانُوا مِنْ قَبْلِهِمْ ۗ  
كَانُوا هُمْ أَشَدَّ مِنْهُمْ قُوَّةً وَآثَارًا فِي  
الْأَرْضِ فَأَخَذَهُمُ اللَّهُ بِذُنُوبِهِمْ ۗ وَمَا  
كَانَ لَهُمْ مِنَ اللَّهِ مِنْ وَاقٍ ﴿٢٢﴾

23. Kjo u ndodhi për shkak se u vinin të Dërguarit e tyre me shenjat e qarta, dhe ata i mohonin. Atëherë Allahu i kapi. Pa dyshim, Ai është shumë i Fuqishëm (dhe) i fortë në ndëshkim.

ذَلِكَ بِأَنَّهُمْ كَانَتْ تَأْتِيهِمْ رُسُلُهُمْ بِالْبَيِّنَاتِ  
فَكَفَرُوا فَأَخَذَهُمُ اللَّهُ ۗ إِنَّهُ قَوِيٌّ شَدِيدُ  
الْعِقَابِ ﴿٢٣﴾

24. Ne dërguam Musain me shenjat Tona dhe me argument të qartë,

وَلَقَدْ أَرْسَلْنَا مُوسَىٰ بِآيَاتِنَا وَسُلْطٰنٍ  
مُّبِينٍ ﴿٢٤﴾

25. drejt Faraonit, Hamanit dhe Karunit. Por ata thanë: “Qenka magjistat (dhe) gënjeshtar i madh!”

إِلَىٰ فِرْعَوْنَ وَهَامَانَ وَقَارُونَ فَقَالُوا  
سِحْرٌ كَذَّابٌ ﴿٢٥﴾

26. Dhe kur (Musai) shkoi te ta me të vërtetën prej Nesh, ata thanë: “Vritni djemtë e atyre që besuan bashkë me të, kurse gratë e tyre mbajini të gjalla!” Kurthi i mohuesve shkon vetëm në humbje.

27. Dhe Faraoni tha: “Më lini ta vras Musain dhe ai le të lusë Zotin e tij. Kam frikë se ai do t’jua ndërrojë fenë ose do të përhapë trazira në tokë.”

28. Dhe Musai tha: “Unë mbrohem me Zotin tim dhe Zotin tuaj nga çdo arrogant që nuk beson në ditën e llogaridhënies.”

29. Dhe një burrë besimtar prej familjes së Faraonit, që fshihte besimin e vet, tha: “A do të vrisni një njeri sepse thotë – Zoti im është Allahu – dhe (se) ai ju solli shenjat e qarta nga Zoti juaj?! Nëse ai është gënjeshtar, gënjeshtër e tij atij do t’i bjerë, dhe nëse është i vërtetë, disa nga paralajmërimet e tij do t’ju godasin ju patjetër. Sigurisht, Allahu nuk udhëzon atë që është shkelës (dhe) gënjeshtar i madh.<sup>6</sup>

فَلَمَّا جَاءَهُمْ بِالْحَقِّ مِنْ عِنْدِنَا قَالُوا  
اقْتُلُوا أَبْنَاءَ الَّذِينَ آمَنُوا مَعَهُ وَاسْتَحْيُوا  
نِسَاءَهُمْ ۗ وَمَا كَيْدُ الْكٰفِرِينَ اِلَّا فِي  
صَلٰلٍ ۝۲۶

وَقَالَ فِرْعَوْنُ ذَرُونِي اَقْتُلْ مُوسٰى  
وَلْيَدْعُ رَبِّهٖ ۗ اِنِّىْٓ اَخَافُ اَنْ يُبَدِّلَ دِيْنَكُمْ  
اَوْ اَنْ يُظْهِرَ فِي الْاَرْضِ الْفَسَادَ ۝۲۷

وَقَالَ مُوسٰى اِنِّىْٓ عُدْتُ بِرَبِّىْ وَرَبِّكُمْ  
ۙ مِنْ كُلِّ مُتَكَبِّرٍ لَا يُؤْمِنُ بِيَوْمِ الْحِسَابِ ۝۲۸

وَقَالَ رَجُلٌ مُّؤْمِنٌ مِّنْ آلِ فِرْعَوْنَ  
يَكْتُمُ اِيْمَانَهٗ اَتَقْتُلُوْنَ رَجُلًا اَنْ يَقُوْلَ  
رَبِّىْٓ اَللّٰهُ وَقَدْ جَاءَكُمْ بِالْبَيِّنٰتِ مِنْ  
رَّبِّكُمْ ۗ وَاِنْ لِّىْٓ كَاذِبًا فَعَلَيْهِ كَذِبُهٗ ۗ  
وَاِنْ لِّىْٓ صٰدِقًا يُصِبُّكُمْ بَعْضَ الَّذِى  
يَعِدُّكُمْ ۗ اِنَّ اللّٰهَ لَا يَهْدِىْ مَنْ هُوَ مُسْرِفٌ  
كٰذِبٌ ۝۲۹

6. Besimtari që përmendet këtu ishte një nga të afërmit e Faraonit dhe një prej prijësve mbretërorë. Sikurse *Hazret Asija*, gruaja e Faraonit, edhe ai e kishte pranuar *Hazret Musain*, ndonëse po e fshihte besimin. Ky ajet tregon se kur Faraoni dhe paria e tij po bënin puç për të vrarë *Hazret Musain*<sup>as</sup>, besimtari në fjalë ua shfaqti besimin duke i këshilluar të tërhiqeshin nga planet e tyre. Dhe si argument, ai u tha: Nëse Musai është gënjeshtar, do ta pësojë pashmangshmërisht për shkak të gënjeshtërisë së tij, sepse nëse ai ka gënjerë në emër të Zotit, Zoti patjetër do ta ndëshkojë atë; por nëse ai është i vërtetë, ju patjetër do të pësoni disa nga fatkeqësitë për të cilat ai ju ka paralajmëruar, derisa të shkatërroheni. Realisht, ky është një kriter universal për vërtetësinë e Profetëve të Zotit, dhe, njëherësh, një këshillë universale për popujt, të cilëve u vijnë profetët.

30. O populli im! Sot e keni ju sundimin si pushtues në tokë. Por kush do të na ndihmojë nga ndëshkimi i Allahut kur do të na zërë ai?!” Faraoni tha: “Unë ju tregoj vetëm atë që shoh dhe ju udhëzoj vetëm në rrugën e mençurisë!”

31. Dhe ai që besoi, tha: “O populli im! Njëmend, unë kam frikë për ju nga diçka që i ngjan kohës së grupeve;

32. i ngjan vorbullës së popullit të Nuhut, asaj të adëve dhe të themudëve dhe të atyre që erdhën më pas. Allahu nuk do padrejtësi për robërit.

33. Dhe o populli im! Unë kam frikë për ju nga dita e thirrjeve;

34. nga dita kur do të ktheheni duke e treguar shpinën. Nuk do të keni asnjë shpëtimtar kundër Allahut. Atë që e cilëson të devijuar Allahu, nuk ka më udhëzues për të.

35. Dhe juve ju kishte ardhur edhe Jusufi më parë me shenjat e qarta, por gjithmonë keni qenë në dyshim për atë që ai ju kishte sjellë. Pasi ai vdiq, ju filluat të thoshit: “Allahu kurrë nuk do të dërgojë më ndonjë të dërguar pas tij”. Kështu devijon Allahu atë që është tejkalues (dhe) dyshues;<sup>7</sup>

يَقَوْمَ لَكُمْ الْمَلِكُ أَيُّومَ ظَهْرَيْنَ فِي  
الْأَرْضِ ۚ فَمَنْ يَنْصُرُنَا مِنْ بَأْسِ اللَّهِ إِنْ  
جَاءَنَا ۗ قَالَ قَالَ فِرْعَوْنُ مَا أُرِيكُمْ إِلَّا مَا  
أَرَى وَمَا أَهْدِيكُمْ إِلَّا سَبِيلَ الرَّشَادِ ۝

وَقَالَ الَّذِينَ آمَنَ يَقَوْمِ إِنِّي أَخَافُ  
عَلَيْكُمْ مِثْلَ يَوْمِ الْأَحْزَابِ ۝

مِثْلَ دَابِ قَوْمِ نُوحٍ وَ عَادٍ وَ ثَمُودَ  
وَ الَّذِينَ مِنْ بَعْدِهِمْ ۗ وَمَا اللَّهُ يُرِيدُ  
ظُلْمًا لِلْعِبَادِ ۝

وَ يَقَوْمِ إِنِّي أَخَافُ عَلَيْكُمْ يَوْمَ التَّنَادِ ۝

يَوْمَ تَوَلَّوْنَ مُدْبِرِينَ ۚ مَا لَكُمْ مِنَ اللَّهِ  
مِنْ عَاصِمٍ ۚ وَمَنْ يُضِلِلِ اللَّهُ فَمَا لَهُ مِنْ  
هَادٍ ۝

وَلَقَدْ جَاءَكُمْ يُوسُفُ مِنْ قَبْلِ الْبَيْتِ  
فَمَا زَلْتُمْ فِي شَكِّ ۖ وَمَا جَاءَكُمْ بِهِ ۗ حَتَّى  
إِذَا هَلَكَ قُلْتُمْ لَنْ نَبْعَثَ اللَّهَ مِنْ بَعْدِهِ  
رَسُولًا ۗ كَذَلِكَ يَضِلُّ اللَّهُ مَنْ هُوَ مُسْرِفٌ  
مُرْتَابٌ ۝

7. Ajeti tregon, ndër të tjera, mendësinë e caktuar të njerëzve. Profetët kanë ardhur në botë që nga kohëra të lashta, por mendimi i njerëzve është aq i çoroditur saqë sa herë që vjen një profet i ri, e refuzojnë, e përqeshin dhe e kundërshtojnë. E kur vdes profeti dhe kalon një kohë

36. ata të cilët luftojnë kundër shenjave të Allahut, edhe pse nuk u ka ardhur ndonjë argument. Kjo është shumë e urryer tek Allahu dhe tek ata që besuan. Kështu Allahu vulos mbi zemrën e çdo mendjemadhi (dhe) mizori.”

الَّذِينَ يُجَادِلُونَ فِي آيَاتِ اللَّهِ بِغَيْرِ سُلْطَانٍ  
أَتَمَّهُمْ كَبْرَ مَقْتًا عِنْدَ اللَّهِ وَعِنْدَ الَّذِينَ  
آمَنُوا كَذَلِكَ يَطْبَعُ اللَّهُ عَلَى كُلِّ قَلْبٍ  
مُتَكَبِّرٍ جَبَّارٍ ﴿٣٦﴾

37. Faraoni tha: “O Haman! Ndërtomë një kullë, që t’i arrij rrugët;

وَقَالَ فِرْعَوْنُ يُهَامُنُ ابْنُ لِي صِرْحًا لَعَلِّي  
أَبْلُغُ الْأَسْبَابَ ﴿٣٧﴾

38. rrugët e qiejve, e të vështroj Zotin e Musait, dhe unë atë e mendoj gënjeshtar!” Kështu iu paraqitën të zbukuruara Faraonit veprat e tij të këqija dhe ai u ndalua nga rruga (e drejtë). Kurse kurthi i Faraonit ishte vetëm në dështim.

أَسْبَابَ السَّمَوَاتِ فَأَطَّلِعَ إِلَى إِلَهِ مُوسَى  
وَإِنِّي لَأَظُنُّهُ كَاذِبًا ۖ وَكَذَلِكَ زُيِّنَ  
لِفِرْعَوْنَ سُوءَ عَمَلِهِ وَصَدَّ عَنِ السَّبِيلِ  
ۗ وَمَا كَيْدُ فِرْعَوْنَ إِلَّا فِي تَبَابٍ ﴿٣٨﴾

39. Dhe ai që besoi tha: “O populli im! Më ndiqni mua, unë do t’ju tregoj rrugën e mençurisë.

وَقَالَ الَّذِي آمَنَ يَوْمَ اتَّبَعُونَ أَهْدِكُمْ  
سَبِيلَ الرَّشَادِ ﴿٣٩﴾

40. O populli im! Jeta e kësaj bote është vetëm një përfitim i shkurtër, kurse ahireti është pikërisht vendi i qëndrueshëm.<sup>8</sup>

يَقَوْمِ إِنَّمَا هَذِهِ الْحَيَاةُ الدُّنْيَا مَتَاعٌ ۗ وَإِنَّ  
الْآخِرَةَ هِيَ دَارُ الْقَرَارِ ﴿٤٠﴾

41. Ai që bëri një të keqe, do të ndëshkohet sa ajo; dhe ai që bëri një të mirë, qoftë mashkull a femër dhe që është besimtar, pikërisht të tillët do të hyjnë në xhenet, ku ata do të begatohen pa masë.

مَنْ عَمِلَ سَيِّئَةً فَلَا يُجْزَى إِلَّا مِثْلَهَا  
وَمَنْ عَمِلَ صَالِحًا مِّنْ ذَكَرٍ أَوْ أُنْثَىٰ وَهُوَ  
مُؤْمِنٌ فَأُولَٰئِكَ يَدْخُلُونَ الْجَنَّةَ يُرْزَقُونَ  
فِيهَا بِغَيْرِ حِسَابٍ ﴿٤١﴾

e gjatë nga vdekja e tij, ata që e quajnë veten besimtarë të tij, fillojnë të thonë: më nuk do të vijë ndonjë profet.

8. Fjala e njeriut besimtar tregon që besimtari duhet të jetë plotësisht i bindur në kauzën e tij të drejtë. Është pikërisht besimi i tij i hekurt që e bën të mundur të durojë me kënaqësi edhe vështirësitë më të rënda.



42. Dhe o populli im! Ç'është kjo që unë ju thërras drejt shpëtimit, kurse ju më thërritni drejt zjarrit!

43. Më thërritkeni që të mohoj Allahun dhe të sajoj ortakë të Tij, gjë për të cilën nuk kam dije! Kurse unë ju thërras drejt të Plotfuqishmit, Falësit të madh!

44. Nuk ka dyshim që ajo drejt së cilës më thërrisni ju, nuk meriton aspak që t'i luteni as në këtë botë e as në ahiret, dhe se kthimi ynë është tek Allahu, dhe pikërisht tejkaluesit do të jenë banorë të zjarrit.

45. Prandaj, do të kujtoni gjithçka që po ju them. Çështjen time ia dorëzoi Allahut. Sigurisht, Allahu është Gjithëshikues mbi robërit.”

46. Atëherë, Allahu e shpëtoi atë nga ligësitë që ata intriguan, kurse popullin e Faraonit e zuri ndëshkimi më i keq;

47. zjarri; mbi të cilin ata sillen mëngjesëve e mbrëmjeve. Dhe ditën kur do të caktohet Ora, (do të thuhet): “Hidheni popullin e Faraonit në ndëshkimin më të fortë!”

48. Ndërsa ata grinden në zjarr, të dobëtit do t'u thonë atyre që ishin mendjemëdhenj: “Ne ju ndiqnim ju, tani, a mund të na shpëtoni nga ndonjë pjesë e zjarrit?”

وَيَقَوْمٌ مَّا لِي أَدْعُوكُمْ إِلَى النَّجْوَةِ  
وَتَدْعُونَنِي إِلَى النَّارِ ۗ ﴿٤٢﴾

تَدْعُونَنِي لِأَكْفُرَ بِاللَّهِ وَأَشْرِكَ بِهِ مَا  
لَيْسَ لِي بِهِ عِلْمٌ وَأَنَا أَدْعُوكُمْ إِلَى  
الْعَزِيزِ الْعَقَّارِ ۗ ﴿٤٣﴾

لَا جَرَمَ أَنَّمَا تَدْعُونَنِي إِلَيْهِ لَيْسَ لَهُ دَعْوَةٌ  
فِي الدُّنْيَا وَلَا فِي الْآخِرَةِ وَأَنْ مَرَدَّنَا إِلَى  
اللَّهِ وَأَنَّ الْمُسْرِفِينَ هُمْ أَصْحَابُ النَّارِ ۗ ﴿٤٤﴾

فَسَتَذْكُرُونَ مَا أَقُولُ لَكُمْ ۗ وَأَفْوُصُ  
أَمْرِي إِلَى اللَّهِ ۗ إِنَّ اللَّهَ بَصِيرٌ بِالْعِبَادِ ۗ ﴿٤٥﴾

فَوَقَّعَهُ اللَّهُ سَيِّئَاتِ مَا مَكَرُوا وَحَاقَ بِآلِ  
فِرْعَوْنَ سُوءُ الْعَذَابِ ۗ ﴿٤٦﴾

النَّارُ يُعْرَضُونَ عَلَيْهَا غُدُوًّا وَعَشِيًّا  
وَيَوْمَ تَقُومُ السَّاعَةُ ۗ أَدْخِلُوا آلَ فِرْعَوْنَ  
أَشَدَّ الْعَذَابِ ۗ ﴿٤٧﴾

وَإِذْ يَتَحَاجَّوْنَ فِي النَّارِ فَيَقُولُ الضُّعْفَاءُ  
لِلَّذِينَ اسْتَكْبَرُوا إِنَّا كُنَّا لَكُمْ تَبَعًا فَهَلْ  
أَنْتُمْ مُنْجُونَ عَنَّا نَصِيًّا مِنَ النَّارِ ۗ ﴿٤٨﴾

49. Ata që ishin mendjemëdhenj, do të thonë: “Ne të gjithë në këtë (zjarr) jemi; sigurisht, Allahu ka vendosur mes robërve.”

قَالَ الَّذِينَ اسْتَكْبَرُوا إِنَّا كُلٌّ فِيهَا ۗ إِنَّ  
اللَّهَ قَدْ حَكَمَ بَيْنَ الْعِبَادِ ۝٤٩

50. Dhe ata që do të jenë në zjarr, do t'u thonë rojave të xhehenemit: “Lutuni Zotit tuaj të na e lehtësojë ndëshkimin ndonjë ditë!”

وَقَالَ الَّذِينَ فِي النَّارِ لِخَزَنَةِ جَهَنَّمَ ادْعُوا  
رَبَّكُمْ يُخَفِّفْ عَنَّا يَوْمًا مِّنَ الْعَذَابِ ۝٥٠

51. Ata do të thonë: “A nuk ju kishin ardhur të Dërguarit tuaj me shenjat e qarta?” “Sigurisht që po”, do të thonë ata. (Rojat) do t'u thonë: “Atëherë lutuni ju!” Por lutja e mohuesve shkon vetëm në humbje.

قَالُوا أَوَلَمْ تَكُ تَأْتِيكُمْ رُسُلُكُمْ  
بِالْبَيِّنَاتِ ۖ قَالُوا بَلَىٰ ۖ قَالُوا فَادْعُوا ۚ وَمَا  
يُغْنِي عَنْكُمْ دَعْوَاهُمُ الْكٰفِرِينَ ۖ إِلَّا فِي ضَلٰلٍ ۝٥١

52. Pa dyshim, Ne i ndihmojmë të Dërguarit Tanë dhe ata që besuan edhe në jetën e kësaj bote, edhe në ditën kur do të ngrihen dëshmitarët.<sup>9</sup>

إِنَّا لَنَنْصُرُ رُسُلَنَا وَالَّذِينَ آمَنُوا فِي  
الْحَيٰوةِ الدُّنْيَا وَيَوْمَ يَقُومُ الْأَشْهَادُ ۝٥٢

53. Ditën kur kërkimfalja e keq-bërësve nuk do të vlejë, dhe ata do të kenë mallkimin dhe do të kenë shtëpinë më të keqe.

يَوْمَ لَا يَنْفَعُ الظَّالِمِينَ مَعٰذِرَتُهُمْ وَلَهُمْ  
اللَّعْنَةُ وَلَهُمْ سُوءُ الدَّارِ ۝٥٣

54. Ne i dhamë udhëzimin Musait dhe ua trashëguam Librin bijve të Izraelit;

وَلَقَدْ آتَيْنَا مُوسَى الْهُدَىٰ وَأَوْرَثْنَا بَنِي  
إِسْرٰءِيلَ الْكِتٰبَ ۝٥٤

55. si udhëzim dhe këshillë për të mençurit.

هُدًى وَذِكْرًا لِأُولِي الْأَلْبَابِ ۝٥٥

9. Zoti u jep premtim të fuqishëm të Dërguarve të Tij, si dhe pasuesve të tyre, se ndihma e Zotit gjithmonë do të jetë me ta edhe në jetën e kësaj bote, dhe se planet e liga të mohuesve kundër tyre, sado të mëdha qofshin, do të dështojnë. Fjalët “ditën kur do të ngrihen dëshmitarët” nënkuptojnë Ditën e Gjykimit, kur fajtorët do të përballen me dëshmi të shumta të pamohueshme kundër tyre.

56. Andaj, duro; premtimi i Allahut patjetër është i vërtetë; kërko falje për dobësinë tënde<sup>10</sup> dhe përkujto Zotin tënd me lavdërim, mbrëmjeve dhe mëngjesëve.

فَاصْبِرْ إِنَّ وَعْدَ اللَّهِ حَقٌّ وَاسْتَغْفِرْ  
لِدُنْيِكَ وَسِبْخِ بِحَمْدِ رَبِّكَ بِالْعَشِيِّ  
وَالْإِبْكَارِ ﴿٥٦﴾

57. Ata që grinden në lidhje me ajetet e Allahut, edhe pse nuk u ka ardhur ndonjë argument, në zemrat e tyre ka një krenari të cilën ata kurrë nuk do ta arrijnë. Kërkoji mbrojtjen Allahut. Pa dyshim, Ai është Gjithëdëgjuesi, Gjithëshikuesi.

إِنَّ الَّذِينَ يَجَادِلُونَ فِي آيَاتِ اللَّهِ بِغَيْرِ  
سُلْطَنِ أَتَهُمْ<sup>١</sup> إِنْ فِي صُدُورِهِمْ إِلَّا  
كِبْرٌ مَا هُمْ بِبَالِغِيهِ<sup>٢</sup> فَاسْتَعِذْ بِاللَّهِ<sup>٣</sup> إِنَّهُ  
هُوَ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ ﴿٥٧﴾

58. Sigurisht, krijimi i qiejve dhe i tokës është më i madh sesa krijimi i njerëzve,<sup>11</sup> por shumica e njerëzve nuk dinë.

لَخَلْقِ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ أَكْبَرُ مِنْ  
خَلْقِ النَّاسِ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا  
يَعْلَمُونَ ﴿٥٨﴾

59. Nuk mund të jenë të barabartë i verbri dhe ai që sheh; as ata që besuan e bënë të mira dhe keqbërësit. Sa pak që pranuanëni këshillën!

وَمَا يَسْتَوِي الْأَعْمَى وَالْبَصِيرُ<sup>١</sup> وَالَّذِينَ  
آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ وَلَا الْمُسِيءُ<sup>٢</sup>  
قَلِيلًا مَّا تَتَذَكَّرُونَ ﴿٥٩﴾

10. Në këtë ajet për të Dërguarin e Allahut<sup>saws</sup> është përdorur fjala “*dhenb*”, që do të thotë “gabim”, por këtu ajo nënkupton dobësinë ose harresën, e jo mëkatin a gjynahun.

11. Disa nga komentuesit e mëparshëm pohojnë se këtu fjala “njerëzit” u referohet edhe Dexhallit (shikoni komentimet Tefsirul-Bagavi, Tefsirul-Kurtubi). Kjo përkon me hadithe të tjera që pohojnë se Dexhalli do të bëjë shpikje kaq të mëdha, sa që do të pretendojë të jetë Zoti. Po kështu, përkon edhe me atë që thotë Zoti në fund të sures El-Kehf për “ata që humbën gjithë mundin e tyre në jetën e kësaj bote dhe mendojnë se po shkëlqejnë në ndërtim” (18:105), ajete për të cilat Profeti<sup>saws</sup> kishte thënë se janë mbrojtje nga Dexhalli (Sunen Ebu Davud, nr. 4323). Pra, duke vënë dorën në krijimet e Zotit, si lëshimi i shiut, nxjerrja e të korrave në mënyrë artificiale, prerja e trupit të njeriut duke e çuar atë në një gjendje “vdekjeje” dhe më pas “ringjallja” e tij duke ia qepur trupin përsëri, ndryshime në krijim qoftë te bimët, te kafshët, madje edhe te njerëzit, shpikjet e shumëllojshme të transportit etj., Dexhalli do të pretendojë të jetë zoti përballë Zotit të vërtetë, dhe do të pohojë se asgjë nuk është e pamundur për të. Përveç kësaj, duke përdorur fjalën “njerëzit” për Dexhallin, ky ajet gjithashtu tregon se Dexhalli nuk është ndonjë “bishë” siç e kanë përfytyruar një pjesë e muslimanëve, por është një grup njerëzish, një shoqëri me ide të caktuara. Dexhalli është një shenjë e Kiametit. Pas dy ajeteve, përmendet edhe Ora, pra Kiameti.

60. Ora patjetër do të vijë; nuk ka dyshim në të. Por shumica e njerëzve nuk besojnë.

إِنَّ السَّاعَةَ لَأْتِيَةٌ لَا رَيْبَ فِيهَا وَلَكِنَّ  
أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يُؤْمِنُونَ ﴿٦٠﴾

61. Dhe Zoti juaj tha: Lutmuni Mua, Unë do t'ju përgjigjem.<sup>12</sup> Sigurisht, ata që tregohen mendjemëdhenj për të Më adhuruar Mua, do të hyjnë të poshtëruar në xhehenem.

وَقَالَ رَبُّكُمْ ادْعُونِي أَسْتَجِبْ لَكُمْ ۗ إِنَّ  
الَّذِينَ يَسْتَكْبِرُونَ عَنْ عِبَادَتِي  
سَيَدْخُلُونَ جَهَنَّمَ دُخْرِينَ ﴿٦١﴾

62. Është Allahu Ai që për ju bëri natën të qetësoheni në të, dhe ditën ndriçuese. Sigurisht, Allahu u bën mirësi të shumta njerëzve, por shumica e tyre nuk falënderojnë.

اللَّهُ الَّذِي جَعَلَ لَكُمُ اللَّيْلَ لِتَسْكُنُوا فِيهِ  
وَالنَّهَارَ مُبْصِرًا ۗ إِنَّ اللَّهَ لَذُو فَضْلٍ عَلَى  
النَّاسِ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَشْكُرُونَ ﴿٦٢﴾

63. Ky është Allahu, Zoti juaj, Krijuesi i çdo gjëje; nuk ka të adhurueshëm tjetër përveç Tij. Atëherë ku po largoheni ju?!

ذِكْرُ اللَّهِ رَبُّكُمْ خَالِقُ كُلِّ شَيْءٍ ۗ لَآ إِلَهَ  
إِلَّا هُوَ ۚ فَاَلْحِقُوا تَوَفُّكُونَ ﴿٦٣﴾

64. Kështu largohen ata që kundërshtojnë shenjat e Allahut.

كَذَلِكَ يُؤَفِّكُ الَّذِينَ كَانُوا بِآيَاتِ اللَّهِ  
يَجْحَدُونَ ﴿٦٤﴾

65. Është Allahu Ai që për ju bëri tokën si vendbanim dhe qiellin si bazë (të mbijetesës suaj), ju dha formë, e shumë bukur ju formoi, dhe

اللَّهُ الَّذِي جَعَلَ لَكُمُ الْأَرْضَ قَرَارًا  
وَالسَّمَاءَ بِنَاءً ۚ وَصَوَّرَكُمْ فَأَحْسَنَ صُورَكُمْ  
وَرَزَقَكُمْ مِّنَ الظُّمْبِطِ ۗ ذَلِكُمْ اللَّهُ

12. Dua (lutja) që Kurani obligoi për muslimanët, ka katër qëllime: 1) Që ty të forcohet besimi në Njëshmërinë e Zotit përmes kthimit tek Ai në çdo moment dhe në çdo situatë, sepse duke iu lutur Zotit për diçka, ti pohon se vetëm Ai të plotëson dëshirat. 2) Që të forcohet besimi, kur të pranohet lutja e të realizohet dëshira. 3) Që të shtohet dija e urtësia, nëse mëshira e Zotit shoqërohet edhe me forma të tjera. 4) Që të shtohet njohja ndaj Zotit, në rast se Zoti të jep premtimin për pranimin e lutjes në formë shpalljeje (*ilhami*) apo ëndrre, dhe më pas të ndodhë ashtu siç të ishte paralajmëruar. Njohja e Zotit, më pas, të shton bindjen, bindja të shton dashurinë dhe dashuria ndaj Zotit të mundëson shpëtimin nga çdo mëkat dhe nga çdo i adhurueshëm tjetër përveç Allahut. Ky pikërisht quhet shpëtimi i vërtetë. Por nëse dikujt i plotësohen dëshirat vetvetiu, pa qenë ai i lidhur me Zotin, në fund, të gjitha dëshirat e tij i kthehen në dëshpërime; të gjitha qejfet e dynjasë, i kthehen në brenga; e gjitha rehatia i shndërrohet në dhimbje e pikëllime. Lexoni edhe 2:187.

ju ushqeju me të pastrat. Ky është Allahu, Zoti juaj. Pra, bekimin e zotëron vetëm Allahu, Zoti i botëve!

66. Është Ai i Gjalli; nuk ka të adhureshëm tjetër përveç Tij, andaj, lutjuni Atij duke ia përkushtuar fenë vetëm Atij. Lavdia është e Allahut, Zotit të botëve.

67. Thuaj: Unë jam ndaluar t'i adhuroj ata që ju u luteni në vend të Allahut, sepse mua më kanë ardhur shenjat e qarta prej Zotit tim, dhe jam urdhëruar t'i nënshtrohem Zotit të botëve.

68. Është Ai që ju krijoi (në fillim) prej dheu, më pas prej sperme, më pas prej droçke gjaku, më pas Ai ju nxjerr si fëmijë, që ju të arrini pjekurinë e më pas të bëheni pleq që të arrini afatin e caktuar; prej jush ka që vdesin edhe më herët; (ky është sistemi) që ju të kuptoni.

69. Është Ai që jep jetë dhe vdekje. Kur Ai vendos një çështje, atëherë asaj i thotë: "Bëhu!", dhe ajo bëhet.

70. A nuk i ke parë ata që grinden në lidhje me shenjat e Allahut? Ku po largohen ata?!

71. Ata që i quajtën gënjeshtër Librin si dhe ato (çështje) që Ne i dërguam përmes të Dërguarve Tanë. Do të mësojnë së shpejti.

رَبُّكُمْ ۖ فَتَبَّرَكَ اللَّهُ رَبَّ الْعَالَمِينَ ۝١٥

هُوَ الْحَيُّ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ فَادْعُوهُ مُخْلِصِينَ  
لَهُ الدِّينَ ۖ الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ ۝١٦

قُلْ إِنِّي نُهِيتٌ أَنْ أَعْبُدَ الَّذِينَ تَدْعُونَ  
مِنْ دُونِ اللَّهِ لَمَّا جَاءَنِي الْبَيِّنَاتُ مِنْ رَبِّي  
وَأُمِرْتُ أَنْ أَسْلِمَ لِرَبِّ الْعَالَمِينَ ۝١٧

هُوَ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ تَرَابٍ ثُمَّ مِنْ نُطْفَةٍ  
ثُمَّ مِنْ عَلَقَةٍ ثُمَّ يُخْرِجُكُمْ طِفْلًا ثُمَّ  
لِتَبْلُغُوا أَشُدَّكُمْ ثُمَّ لِتَكُونُوا شُيُوخًا  
وَمِنْكُمْ مَنْ يُتَوَفَّى مِنْ قَبْلٍ وَلِتَبْلُغُوا  
أَجَلًا مُّسَمًّى ۚ وَلِلَّهِ كُفْرُكُمْ تَعْقِلُونَ ۝١٨

هُوَ الَّذِي يُحْيِي وَيُمِيتُ ۚ فَإِذَا قَضَىٰ أَمْرًا  
يَقُولُ ۚ فَإِنَّمَا يَقُولُ لَهُ كُنْ فَيَكُونُ ۝١٩

أَلَمْ تَرَ إِلَى الَّذِينَ يُجَادِلُونَ فِي آيَاتِ اللَّهِ  
أَنِّي يُضْرَقُونَ ۝٢٠

الَّذِينَ كَذَّبُوا بِالْكِتَابِ وَبِمَا أَرْسَلْنَا بِهِ  
رُسُلَنَا فَسَوْفَ يَعْلَمُونَ ۝٢١

72. Kur do të kenë nëpër qafa pranga e zinxhirë, (me të cilët) do të zvarriten;

إِذِ الْأَعْلَىٰ فِي أَعْنَاقِهِمْ وَالسَّلْسِلَٰٓءُ  
يُسْحَبُونَ ﴿٧٢﴾

73. në ujë të valë. Pastaj do të flakërojnë në zjarr.

فِي الْحَمِيمِ ۖ ثُمَّ فِي النَّارِ يُسْجَرُونَ ﴿٧٣﴾

74. Pastaj do t'u thuhet: “Ku janë ato që adhuronit

ثُمَّ قِيلَ لَهُمْ أَيْنَ مَا كُنْتُمْ تُشْرِكُونَ ﴿٧٤﴾

75. në vend të Allahut?” Ata do të thonë: “Na humbën, madje ne nuk i luteshim asgjëje më parë.” Kështu Allahu i cilëson të devijuar mohuesit.

مِنْ دُونِ اللَّهِ ۖ قَالُوا صَلُّوا عَلَيْنَا بَل لَّئِمَّا  
كُنَّا نَدْعُوا مِنْ قَبْلُ شَيْئًا ۚ كَذٰلِكَ يُضِلُّ  
اللَّهُ الْكٰفِرِيْنَ ﴿٧٥﴾

76. Kjo ju ndodh për shkak se mburreshit pa të drejtë në tokë dhe për shkak se fryheshit (para të tjerëve).

ذٰلِكُمْ بِمَا كُنْتُمْ تَفْرَحُوْنَ فِي الْاَرْضِ بِغَيْرِ  
الْحَقِّ وَبِمَا كُنْتُمْ تَمْرَحُوْنَ ﴿٧٦﴾

77. Hyni në portat e xhehenemit! Do të jetoni gjatë atje! Sa e keqe qenka streha për mendjemëdhenjtë!

اُدْخُلُوا الْاَبْوَابَ جَهَنَّمَ خٰلِدِيْنَ فِيْهَا ۗ فَيَسَّ  
مَثْوٰى الْمُتَكَبِّرِيْنَ ﴿٧٧﴾

78. Duro. Premtimi i Allahut patjetër është i vërtetë. Ne në daç të tregojmë ty disa gjëra nga ato për të cilat i kemi paralajmëruar, në daç të japim vdekje, ata te Ne do të kthehen.

فَاصْبِرْ ۗ اِنَّ وَعْدَ اللّٰهِ حَقٌّ ۗ فَاِمَّا نُرِيَنَّكَ  
بَعْضَ الَّذِيْ نَعِدُهُمْ اَوْ نَتَوَفَّيَنَّكَ فَاِلَيْنَا  
يُرْجَعُونَ ﴿٧٨﴾

79. Pa dyshim, edhe para teje kemi dërguar shumë të dërguar, për disa prej tyre të kemi rrëfyer dhe për disa prej tyre nuk të kemi rrëfyer. Asnjë i dërguar nuk ka mundësi të sjellë ndonjë shenjë, pa lejen e Allahut. E kur vjen urdhri i Allahut, vendoset me drejtësi. Dhe atëherë do të

وَلَقَدْ اَرْسَلْنَا رُسُلًا مِّنْ قَبْلِكَ مِنْهُمْ مَّن  
قَضَصْنَا عَلَيْكَ وَمِنْهُمْ مَّنْ لَّمْ نَقْضُصْ  
عَلَيْكَ ۗ وَمَا كَانَ لِرِسُوْلٍ اَنْ يَّاتِيَ بِاٰيَةٍ  
اِلَّا بِاِذْنِ اللّٰهِ ۗ فَاِذَا جَاءَ اَمْرُ اللّٰهِ فُضِيَ

humbin mohuesit.<sup>13</sup>

80. Allahu është Ai që krijoi kafshët për ju, që me disa prej tyre të udhëtoni e me disa të tjera të ushqeheni;

81. në to keni dobi të shumta; dhe (i krijoi) që nëpërmjet tyre të arrini dëshirën që keni në zemrat tuaja, dhe të mbarteni mbi to dhe (po kështu edhe) mbi anijet.

82. Ai ju tregon Shenjat e Tij. Atëherë cilën nga shenjat e Allahut do ta mohoni?!

83. Ata a nuk shëtitën në tokë që të shihnin se si qe fundi i atyre që ishin më parë?! Ishin më të shumtë në numër se këta dhe (ishin) më të fortë për nga forca dhe për nga shenjat (e madhështisë) që lanë në tokë, por nuk u vlejti dot ajo që ata punonin.

84. E kur u erdhën të Dërguarit e tyre me shenjat e qarta, ata mbetën

بِالْحَقِّ وَخَسِرَ هُنَالِكَ الْمُبْطِلُونَ ﴿٥٧﴾

اللَّهُ الَّذِي جَعَلَ لَكُمْ الْأَنْعَامَ لِتَرْكَبُوا  
مِنْهَا وَمِنْهَا تَأْكُلُونَ ﴿٥٨﴾

وَلَكُمْ فِيهَا مَنَافِعُ وَتَتَّبِعُوا عَلَيْهَا حَاجَةً  
فِي صُدُورِكُمْ وَعَلَيْهَا وَعَلَى الْفُلْكِ  
تُحْمَلُونَ ﴿٥٩﴾

وَيُرِيكُمْ آيَاتِهِ فَآى آيَاتِ اللَّهِ تُنْكِرُونَ ﴿٦٠﴾

أَفَلَمْ يَسِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَيَنْظُرُوا كَيْفَ  
كَانَ عَاقِبَةُ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ ۗ كَانُوا  
أَكْثَرِ مِنْهُمْ وَأَشَدَّ قُوَّةً وَآثَارًا فِي  
الْأَرْضِ فَمَا أَعْنَى عَنْهُمْ مِمَّا كَانُوا  
يَكْسِبُونَ ﴿٦١﴾

فَلَمَّا جَاءَتْهُمْ رُسُلُهُم بِالْبَيِّنَاتِ فَرِحُوا بِمَا  
عِنْدَهُمْ مِنَ الْعِلْمِ وَحَاقَ بِهِمْ مِمَّا كَانُوا

13. Në një ajet tjetër Zoti thotë që nuk ka popull në botë, të cilit Ai të mos i ketë dërguar ndonjë profet (35:25). Dhe ky ajet e plotëson këtë temë duke thënë se ka Profetë që Kurani i ka përmendur, por ka edhe Profetë të tjerë që nuk i ka përmendur. Këto ajete nxisin muslimanët të kenë mirëbesim dhe respekt ndaj çdo profeti që ka ardhur kudo qoftë në botë. Pra, ata nuk duhet të diskreditojnë dhe nuk duhet të përdorin gjuhë fyese ndaj ndonjë profeti, të cilin një masë e madhe njerëzish e kanë pranuar. Shikoni sa i bukur është ky parim që vendos themelin e paqes në botë dhe synon të mbledhë të gjithë popujt nën një parim të vetëm, i cili është që duhet të respektoni udhëheqësit fetarë të feve të njëri-tjetrit. Kush mund të mohojë që një prej shkaqeve kryesore të urrejtjes mes popujve është pikërisht poshtërimi dhe përdorimi i gjuhës fyese ndaj Profetëve të feve të njëri-tjetrit, profetë të cilët janë pranuar nga miliona njerëz?! Ai që fyen profetin e një feje të caktuar dhe njëkohësisht pretendon të bashkëjetojë në paqe me ndjekësit e asaj feje, është thjesht naiv ose hipokrit i pashembullt. Nuk mund të ndodhë që një njeri që fyen rëndë dikë nga babai, të dëshirojë të ketë edhe raporte të mira me të. Lexoni edhe 4:165.

duke u mburrur me atë dije që kishin, dhe i rrethoi ajo që ata përqeshnin.<sup>14</sup>

بِهِ يَسْتَهْزِءُونَ ﴿٨٤﴾

85. Dhe kur panë ndëshkimin Tonë, thanë: “Besuam në Allah që është i Vetëm dhe i mohuam të gjitha ato që i besonim ortakë të Tij!”

فَلَمَّا رَأَوْا بَأْسَنَا قَالُوا آمَنَّا بِاللَّهِ وَحَدَهُ  
وَكُفِّرْنَا بِمَا كُنَّا بِهِ مُشْرِكِينَ ﴿٨٥﴾

86. Por nuk u vlejti dot besimi i tyre në kohën kur e panë ndëshkimin Tonë; praktikë e Allahut që u përsërit te robërit e Tij; dhe atëherë mohuesit humbën.

فَلَمْ يَكْ يَنْفَعُهُمْ إِيمَانُهُمْ لَمَّا رَأَوْا  
بَأْسَنَا سُنَّتَ اللَّهُ الَّتِي قَدْ خَلَتْ فِي  
عِبَادِهِ ۗ وَحَسِرَ هُنَالِكَ الْكٰفِرُونَ ﴿٨٦﴾

14. Një prej gabimeve të rënda që shumë njerëz e bëjnë sidomos në çështjet e fesë është që “mbeten duke u mburrur me atë dije që kanë”. Andaj, privohen nga argumenti dhe nga dija e vërtetë. Ky ves i krijon njeriut pengesa jo vetëm në përpjekjet në rrugën e Allahut dhe në arritjen e Njohjes së Tij, por në kërkimin e dijes të çdo fushe tjetër. Lexoni edhe 38:3.



## Surja 41 – Ha.Mim. Es-Sexhde

Surja Ha.Mim. Es-Sexhde [quhet edhe Fussilet] është mekase, dhe bashkë me *bismil-lahin*, ka pesëdhjetë e pesë ajete.

Pas sures El-Mu'min vjen surja Ha.Mim Es-Sexhde, e cila gjithashtu fillon me shkurtesat *Ha.Mim.*

Që në fillim të kësaj sureje vjen deklarata që Kurani është zbritur në një gjuhë kaq të pasur dhe letrare, e cila zbërthen temat në mënyrë shumë të qartë, megjithatë, mohuesit duke iu përgjigjur kësaj deklarate pohojnë – Zemrat tona janë në perde; kemi dyllë në veshë; na pengon një barrë. Dhe duke iu drejtuar të Dërguarit të Allahut, ata i bëjnë sfidë – Bëj çfarë të duash, edhe ne e kemi një synim në punët tona. Kjo nuk nënkupton që armiqtë e lënë Profetin e Allahut të lirë që ai të predikojë si të dojë, përkundrazi, tregon qëndrimin e mohuesve që i thonë – Ti vepro në mënyrën tënde, kurse ne do të punojmë pa pushim që ti të dështosh në planet e tua.

Përgjigja e kësaj sfide që Allahu i Madhërishëm ia mësoi Profetit Muhammed<sup>savs</sup> është – Thuaju: Jam një njeri si ju, por mua më zbret shpallja dhe kjo na dallon në si nata me ditën.

Në këtë sure, ka disa ajete, të cilat disa njerëz i kundërshtojnë duke i keqkuptuar. Për shembull, për ajetet nr. 11 – 13 thonë se flasin për kohën e krijimit të universit kur gjithësia ishte përhapur si një mjegull në tërë hapësirën, por po të jetë i saktë ky komentim, nuk mund të shpjegohet krijimi i Tokës, që në fakt, u krijua shumë vonë pas kësaj ngjarjeje, kurse në ajetet që po flasim, thuhet se Toka u krijua përpara kësaj.

Në të vërtetë, këto ajete flasin për krijimin e Tokës dhe për sisteme të ndryshme të ushqimit që janë krijuar brenda këtij planeti, sisteme të cilat përfunduan në katër periudha, ku ngritja e maleve ka luajtur rolin qendror. Më pas Kurani pohon se qielli sipër ishte si mjegull. Kjo mjegull në fakt ishin avuj që ishin shumë më lart se shtatë qiej, të cilët nënkuptojnë shtatë shtresa të atmosferës së Tokës. Këta avuj sa herë që i afroreshin Tokës, ktheheshin përsëri në lartësi për shkak të nxehtësisë së madhe që kishte Toka. Kjo ishte situata në Tokë për një periudhë shumë të gjatë. Më në fund, uji filloi të binte në Tokë dhe, me kalimin e kohës, u formuan detet, prej të cilave avujt përsëri filluan të ngriheshin, por tanimë duke u përplasur me male, shkarkoheshin përsëri në Tokë. Pas kësaj, në dy periudha të tjera, u formuan shtatë qiej afër Tokës, që janë shtresat e atmosferës së saj, dhe në çdo shtresë të këtij qielli janë vendosur ligjet përkatëse se çfarë funksionesh do të kryejë ajo. Sot shkencëtarët flasin për shtatë shtresa të atmosferës që e rrethojnë Tokën duke i emërtuar me emra të ndryshëm dhe duke përcaktuar funksione të ndryshme që ato kryejnë, pa të cilat Toka nuk mund të kishte jetë. Të gjitha këto shtresa qiellore janë të përcaktuara për mbrojtjen e Tokës dhe të banorëve të saj.

Kjo sure porosit Profetin Muhammed<sup>savs</sup> të tregojë qëndrueshmëri, të cilën e shtjellon më tej, dhe shpërblimin e saj e përshkruan në dy pjesë. Në pjesën e parë u jep lajmin e mirë besimtarëve duke thënë se nëse ata tregohen të palëkundur përballë mizorive të armikut, Allahu i Madhërishëm do t'u zbresë engjëj, të cilët do t'u japin zemër, do t'u flasin dhe do t'i qetësojnë duke thënë – Ne jemi me ju edhe në këtë botë, edhe në *ahiret*.

Më pas, [në pjesën e dytë], në ajetet që fillojnë nga nr. 34, është zgjeruar më tej kjo temë: “Kush mund të jetë më i mirë se ai në fjalë që fton (të tjerët) drejt Allahut ...?!” Këtu thuhet: Përveç qëndrueshmërisë që do të tregoni përballë vështirësive, nëse mbështeteni tek Allahu dhe nëse nuk lodheni duke iu dhënë kundërshtarëve mesazhin e Islamit me durim dhe urtësi, atëherë ata që janë armiq sot, do t'ju bëhen miq të ngushtë nesër. Kjo mrekulli në shkallën më të lartë u përmbush përmes personalitetit të Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, i cili ishte më durimtari se çdokush tjetër. Zoti i Madhërishëm atij i kishte dhuruar durim të madh. Dhe bota dëshmoi që shumë nga armiqtë e tij, të cilët donin me çdo kusht ta vrisnin atë, gjatë jetës së tij, iu bënë miq flijues.

Në fund të kësaj sureje, Zoti u thotë atyre që mohojnë takimin me Të: Ne do t'ju tregojmë plot shenja, që do të shfaqen edhe në horizont, dhe që do të kenë lidhje edhe me sistemin jashtëzakonisht të sofistikuar të jetës, pra që do të jenë të lidhura vetë me trupin dhe jetën tuaj. Atëherë ata që do të gëzojnë mundësinë për të reflektuar, duke parë shenjat qoftë në hapësirë, qoftë në jetën e tyre, në mënyrë të vetvetishme do të pohojnë:

*“O Zoti ynë! Këto nuk i ke krijuar kot! Ti je i Shenjtë. Andaj, na shpëto nga ndëshkimi i zjarrit!” (3:192)*



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ ﴿١﴾

2. *Ha.Mim.* (I Lavdishëm, i Nde-ruar.)

حَمِیْمٌ ﴿٢﴾

3. Zbritja (e tij) është prej të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

تَنْزِیْلٌ مِّنَ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ ﴿٣﴾

4. (Ky është) një Libër, ajetet e të cilit janë shpjeguar hollësisht (dhe është) në formën e një Kurani elokuent, për njerëzit që dinë.

کِتٰبٌ فُصِّلَتْ اٰیٰتُهٗ قُرْاٰنًا عَرَبِیًّا لِّقَوْمٍ یَّعْلَمُوْنَ ﴿٤﴾

5. (është) sihariqdhënës dhe alar-mues. Shumica e tyre e shpërfillën, andaj, ata nuk dëgjojnë.

بَشِیْرًا وَّ نَذِیْرًا ۚ فَاَعْرَضَ اَكْثَرُهُمْ فَهُمْ لَا یَسْمَعُوْنَ ﴿٥﴾

6. Dhe thanë: “Zemrat tona janë të mbyllura për atë që na fton ti; në veshët tanë kemi një barrë dhe midis nesh e teje ka perde, andaj ti vepro (dhe) sigurisht, edhe ne do të veprojme.”

وَقَالُوْا قُلُوْبُنَا فِیْ اَكْنٰتٍ مِّمَّا تَدْعُوْنَا اِلَیْهِ وَفِیْ اٰذَانِنَا وَقْرٌ وَّ مِنْ بَیْنِنَا وَبَیْنِكَ حِجَابٌ فَاَعْمَلْ اِنَّا عٰمِلُوْنَ ﴿٦﴾

7. Thuaj: Unë jam thjesht një njeri si ju, mua më shpallet që i adhureshmi juaj është vetëm një, andaj drejt Tij qëndroni në mënyrë të palëkundur dhe Atij kërkoni falje. U mjerofshin idhujtarët!

قُلْ اِنَّمَا اَنَا بَشَرٌ مِّثْلُكُمْ یُوْحٰی اِلَیَّ اَنْمَآ اِلَهُكُمْ اِلٰهٌ وَّاحِدٌ فَاَسْتَقِیْمُوْا اِلَیْهِ وَاسْتَغْفِرُوْهُ ۗ وَوَيْلٌ لِّلْمُشْرِکِیْنَ ﴿٧﴾

8. Ata që nuk japin zekatin dhe janë pikërisht ata që e mohojnë ahiretin.

الَّذِیْنَ لَا یُوْتُوْنَ الزَّكٰوةَ وَهُمْ بِالْاٰخِرَةِ هُمْ کٰفِرُوْنَ ﴿٨﴾

9. Pa dyshim, ata që besuan dhe bënë të mira, do të kenë shpërblim të pandërprerë.

إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَهُمْ  
عِجْرًا جَيْرًا مَمْنُونٍ ①

10. Thuaj: A e mohoni Atë që krijoi tokën në dy ditë<sup>1</sup> dhe Atij i caktoni ortakë? (Ta dini), Ai është Zoti i botëve.

قُلْ أَيْنَكُمْ تَتَكْفَرُونَ بِالَّذِي خَلَقَ  
الْأَرْضَ فِي يَوْمَيْنِ وَتَجْعَلُونَ لَهُ أَندَادًا  
ذَلِكَ رَبُّ الْعَالَمِينَ ②

11. Ai krijoi male sipër saj, i bekoi ato dhe caktoi ushqimet që burojnë prej tyre në katër ditë. Ato janë njësoj për të gjithë kërkuesit.

وَجَعَلَ فِيهَا رَوَاسِيَ مِنْ فَوْقِهَا وَبُرُكٌ فِيهَا  
وَقَدَّرَ فِيهَا أَقْوَاتَهَا فِي أَرْبَعَةِ أَيَّامٍ  
سَوَاءً لِّلسَّالِبِينَ ③

12. Më pas Ai iu drejtua qiellit që ishte tym. I tha atij dhe tokës: “Ejani me hir a me pahir!” Ata thanë: “Erdhëm të nënshtuar.”

ثُمَّ اسْتَوَىٰ إِلَى السَّمَاءِ وَهِيَ دُخَانٌ فَقَالَ  
لَهَا وَاللَّأَرْضَ ائْتِيَا طَوْعًا أَوْ كَرْهًا ۗ قَالَتَا  
أَتَيْنَا طَائِعِينَ ④

13. Atëherë Ai i bëri shtatë qiej në dy ditë dhe në secilin qiell shpalli ligjin e vet. Dhe Ne zbukuruam qiellin e botës me ndriçime dhe mbrojtës. Ky është caktimi i Mbizotëruesit, të Gjithëdijshmit.

فَقَضَاهُنَّ سَبْعَ سَمَوَاتٍ فِي يَوْمَيْنِ وَ  
أَوْحَىٰ فِي كُلِّ سَمَاءٍ أَمْرَهَا ۗ وَزَيَّنَّا السَّمَاءَ  
الدُّنْيَا بِمَصَابِيحٍ ۗ وَحِفْظًا ۗ ذَٰلِكَ تَقْدِيرُ  
الْعَزِيزِ الْعَلِيمِ ⑤

14. Nëse ata ta kthejnë shpinën, thuaj: Ju paralajmëroj për një ndëshkim, ngjashëm me ndëshkimin e adëve dhe të themudëve.

فَإِنْ أَعْرَضُوا فَقُلْ أَنْذَرْتُكُمْ صُحُفَةً  
مِّثْلَ صُحُفَةِ عَادٍ وَثَمُودَ ⑥

15. Kur atyre u erdhën të Dërguarit edhe gjatë jetës së tyre (dhe), edhe më parë, që (thanë): “Mos adhuroni askënd përveç Allahut!”, ata thanë: “Po të donte Zoti ynë, Ai patjetër do të zbriste engjëj; andaj, mesazhin që

إِذْ جَاءَتْهُمْ الرُّسُلُ مِنْ بَيْنِ أَيْدِيهِمْ  
وَمِنْ خَلْفِهِمْ أَلَّا تَعْبُدُوا إِلَّا اللَّهَ ۗ قَالُوا  
لَوْ شَاءَ رَبُّنَا لَأَنْزَلَ مَلَائِكَةً فَأِنَّا بِمَا

1. Ajetet 10 – 13: Fjala “ditë” në këto ajete nuk do të thotë ditë që shohim ne, por nënkupton periudhë të caktuar kohe. Lexoni shpjegimin e këtyre ajeteve në parathënien e sures.

ju e keni sjellë, ne po e mohojmë.”

أَرْسَلْتُمْ بِهِ كُفْرًا ۝

16. Për sa u përket adëve, ata u treguan mendjemëdhenj në tokë, pa të drejtë, dhe thanë: “Kush qenka më i fuqishëm se ne?!” A nuk kishin menduar që Allahu i cili i krijoi, është më i Fuqishëm se ata?! Ata vetëm se i kundërshtonin shenjat Tona.

فَأَمَّا عَادٌ فَاسْتَكْبَرُوا فِي الْأَرْضِ بِغَيْرِ الْحَقِّ وَقَالُوا مَنْ أَشَدُّ مِنَّا قُوَّةً أَوَلَمْ يَرَوْا أَنَّ اللَّهَ الَّذِي خَلَقَهُمْ هُوَ أَشَدُّ مِنْهُمْ قُوَّةً وَكَانُوا بِآيَاتِنَا يَجْحَدُونَ ۝

17. Atëherë Ne dërguam mbi ta një furtunë të acartë në ditë të kobshme, që t’i bënim ta shijonin ndëshkimin poshtërues (që) në jetën e kësaj bote. Dhe ndëshkimi i *ahiretit* do të jetë (edhe) më poshtërues, dhe ata nuk do të ndihmohen.

فَأَرْسَلْنَا عَلَيْهِمْ رِيحًا صَرْصَرًا فِي أَيَّامٍ نَحْسَاتٍ لِنُذِيقَهُمْ عَذَابَ الْخِزْيِ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَلَعَذَابُ الْآخِرَةِ أَخْرَىٰ وَهُمْ لَا يُنصَرُونَ ۝

18. Për sa u përket themudëve, edhe atyre u dhamë udhëzimin, por ata pëlqyen verbërinë në vend të udhëzimit, atëherë i zuri ndëshkimi turpërues për shkak të asaj që punonin.

وَأَمَّا ثَمُودُ فَهَدَيْنَاهُمْ فَاسْتَجَبُوا أَلْعَىٰ عَلَى الْهُدَىٰ فَآخَذْنَاهُمْ صِغِقَةً الْعَذَابِ الْهُونِ بِمَا كَانُوا يَكْسِبُونَ ۝

19. Dhe i shpëtuan ata që besuan dhe që kishin drujtje (ndaj Nesh).

وَنَجَّيْنَا الَّذِينَ آمَنُوا وَكَانُوا يَتَّقُونَ ۝

20. Dhe ditën kur do të mblidhen armiqtë e Allahut te zjarri, ata do të ndahen në tufa-tufa.

وَيَوْمَ يُحْشَرُ أَعْدَاءُ اللَّهِ إِلَى النَّارِ فَهُمْ يُوزَعُونَ ۝

21. Derisa kur do të mbërrijnë tek ai, veshët e tyre, sytë e tyre dhe lëkurat e tyre do të dëshmojnë vetë kundër tyre për atë që kishin bërë.

حَتَّىٰ إِذَا مَا جَاءُوهَا شَهِدَ عَلَيْهِمْ سَمْعُهُمْ وَأَبْصَارُهُمْ وَجُلُودُهُمْ بِمَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ۝

22. Ata do t’u thonë lëkurave të tyre: “Pse po dëshmoni kundër nesh?” Ato do t’u përgjigjen: “Na bëri Allahu të

وَقَالُوا لَوْلَا جُلُودُهُمْ لَمَ شَهِدْتُمْ عَلَيْنَا قَالُوا أَنْطَقَنَا اللَّهُ الَّذِي أَنْطَقَ كُلَّ شَيْءٍ وَهُوَ

flisnim; Ai që bëri çdo gjë të flasë dhe pikërisht Ai ju krijoi për herë të parë dhe po tek Ai do të ktheheni.”

حَقَّقَكُمْ أَوَّلَ مَرَّةٍ وَإِلَيْهِ تُرْجَعُونَ ﴿٢١﴾

23. “Ju nuk mund të fshiheshit nga dëshmimi i veshëve, i syve dhe i lëkurave tuaja kundër jush, dhe menduat që Allahu nuk ditka shumë nga ato që bënit.<sup>2</sup>

وَمَا كُنْتُمْ تَسْتَرُونَ أَنْ يَشْهَدَ عَلَيْكُمْ سَمْعُكُمْ وَلَا أَبْصَارُكُمْ وَلَا جُلُودُكُمْ وَلَكِنْ ظَنَنْتُمْ أَنَّ اللَّهَ لَا يَعْلَمُ كَثِيرًا مِمَّا تَعْمَلُونَ ﴿٢٣﴾

24. Dhe ky mendim juaji që patët për Zotin tuaj, ju shkatërroi dhe u bëtë humbës.”

وَذِكْرُكُمْ ظَنَنْتُمْ الَّذِي ظَنَنْتُمْ بِرَبِّكُمْ أَرْدَكُمْ فَأَصْبَحْتُمْ مِنَ الْخَسِرِينَ ﴿٢٤﴾

25. Pra, nëse durojnë, sërish zjarri do të jetë streha e tyre dhe, nëse kërkojnë falje, nuk do të falen.

فَإِنْ يَصْبِرُوا فَالتَّارُ مَثْوَى لَهُمْ ؕ وَإِنْ يَسْتَغِيثُوا فَمَا لَهُمْ مِنَ الْمُعْتَبِينَ ﴿٢٥﴾

26. Ne u kemi ngjitur disa shoqërues, të cilët ua bënë joshëse atë që ishte përpara tyre si dhe atë që ishte pas tyre, atëherë për ta u vërtetua fjala që kaloi edhe në disa popuj prej xhindëve dhe njerëzve më parë. Sigurisht, ata ishin humbës.

وَقَيَّضْنَا لَهُمْ قُرَنَاءَ فَزَيَّنُوا لَهُمْ مَا بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَمَا خَلْفَهُمْ وَحَقَّ عَلَيْهِمُ الْقَوْلُ فِي أُمِّ قَدْحَلَتْ مِنْ قَبْلِهِمْ مِنَ الْجِنَّةِ وَالنَّاسِ ؕ إِنَّهُمْ كَانُوا خَسِرِينَ ﴿٢٦﴾

27. Ata që mohuan thanë: “Mos e dëgjoni këtë Kuran, madje bëni zhurmë gjatë (leximit të) tij që të mbizotëroni!”

وَقَالَ الَّذِينَ كَفَرُوا لَا تَسْمَعُوا لِهَذَا الْقُرْآنِ وَالْغَوْا فِيهِ لَعَلَّكُمْ تَعْلَبُونَ ﴿٢٧﴾

2. Ajetet 21 – 23 tregojnë se Ditën e Gjykimit, dëshmitë që do të ngrihen kundër keqberësve, çuditërisht e para prej tyre do të jetë dëshmia e lëkurës. Në kohën kur u zbrit Kuran askush nuk mund të perceptonte dot dëshminë e lëkurës, por në kohët tona shkencëtarët kanë vërtetuar se si fiziku i njeriut ashtu edhe psikika e tij është e ruajtur në çdo qelizë të lëkurës së tij. Madje, nëse ndonjë kafshë e varrosur para qindra mijëra vitesh, ka të gjallë qoftë një qelizë të lëkurës së saj, sipas shkencëtarëve, mund të realizohet riprodhimi i asaj kafshe. Përpjekjet e inxhinierisë gjenetike për të riprodhuar qoftë një kafshë apo njeri me anë të qelizave të lëkurës, janë provë e vërtetësisë së këtyre fjalëve të Kuranit të Shenjtë.

28. Andaj, ata që mohuan, Ne patjetër do t'i bëjmë të shijojnë një ndëshkim të fortë dhe do t'i dënojmë për veprat më të këqija që ata bënin.

29. Zjarr! I tillë është dënimi i armiqve të Allahut. Në të do të kenë vendbanim për një kohë të gjatë. Dënim për shkak se i kundërshtonin me vetëdije ajetet Tona.

30. Dhe ata që mohuan do të thonë: “O Zoti ynë! Tregona ata, nga xhindët dhe njerëzit, që na devijuan, që ne t'i shkelim nën këmbët tona dhe që ata të bëhen më të ulët!”<sup>3</sup>

31. Pa dyshim, ata që thanë: “Zoti ynë është Allahu”, më pas treguan qëndrueshmëri, atyre u zbresin engjëjt (duke thënë): “Mos u frikësoni e mos u brengosni dhe gëzohuni për xhenetin që ju premtohet.

32. Ne jemi miqtë tuaj edhe në jetën e kësaj bote, edhe në *ahiret*, dhe në të do të keni gjithçka që pëlqejnë shpirtrat tuaj, dhe në të do të keni gjithçka që kërkoni.”<sup>4</sup>

فَلَنذِيقَنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا عَذَابًا شَدِيدًا<sup>١</sup>  
وَلَنَجْزِيَنَّهُمْ أَسْوَأَ الَّذِي كَانُوا يَعْمَلُونَ<sup>٢</sup>

ذَلِكَ جَزَاءُ أَعْدَاءِ اللَّهِ الثَّارِ<sup>٣</sup> لَهُمْ فِيهَا  
دَارُ الْخُلْدِ<sup>٤</sup> جَزَاءٌ بِمَا كَانُوا يَأْتِنَا  
يَجْحَدُونَ<sup>٥</sup>

وَقَالَ الَّذِينَ كَفَرُوا رَبَّنَا أَرِنَا الَّذِينَ  
أَصَلْنَا مِنَ الْجِنِّ وَالْإِنْسِ نَجْعَلُهُمَا  
تَحْتَ أَقْدَامِنَا لِيَكُونُوا مِنَ الْأَسْفَلِينَ<sup>٦</sup>

إِنَّ الَّذِينَ قَالُوا رَبَّنَا اللَّهُ ثُمَّ اسْتَقَامُوا  
تَتَنَزَّلُ عَلَيْهِمُ الْمَلَائِكَةُ أَلَّا تَخَافُوا وَلَا  
تَحْزَنُوا وَابْشِرُوا بِالْجَنَّةِ الَّتِي كُنتُمْ  
تُوَعَدُونَ<sup>٧</sup>

نَحْنُ أَوْلِيَؤُكُمْ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَفِي  
الْآخِرَةِ<sup>٨</sup> وَلَكُمْ فِيهَا مَا تَشْتَهَى أَنْفُسُكُمْ  
وَلَكُمْ فِيهَا مَا تَدْعُونَ<sup>٩</sup>

3. Një ajet tjetër si ky, në vend të “xhindëve dhe njerëzve”, përdor “prijësit dhe të mëdhenjtë” (33:68), dhe kështu e sqaron se cilët xhindë janë këta.

4. Ajetet 31 – 32 deklarojnë se shpallja Hyjnore është e pandërprerë përgjithmonë. Sigurisht, Libri është i kompletuar, gjë që tregon se shpalljet që mund t'i shtonin ose t'i hiqnin diçka Kuranit të Shenjtë, nuk ka më dhe nuk do të ketë deri në Kiamet. Por komunikimi me Zotin qoftë përmes shpalljeve, apo përmes dërgimit të engjëjve, kurrë nuk do të mbyllet. Po, ky lloj shpalljesh u zbrit atyre njerëzve që tregohen të qëndrueshëm në rrugën e Allahut dhe të palëkundur gjatë sprovave që u vijnë. Dhe kjo si bekim u sigurohet vetëm atyre robërve që janë shërbëtorë të sinqertë të Kuranit dhe të Profetit Muhammed<sup>savs</sup>. Engjëjt u zbresin njerëzve të tillë dhe u thonë: ‘Jemi miqtë tuaj edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër dhe juve do t’ju plotësohen të gjitha dëshirat e pastra’. Tani, nuk mundet që engjëjt edhe të zbresin, edhe të

33. Si një mikpritje prej Falësit, Mëshirëbërësit.”

لَا تُزِلُنَا مِنْ غُفُورٍ رَحِيمٍ ﴿٣٣﴾

34. E kush mund të jetë më i mirë në fjalë se ai që fton (të tjerët) drejt Allahut, bën të mira dhe thotë: “Sigurisht, unë jam ndër të nënshtruarit”?!

وَمَنْ أَحْسَنُ قَوْلًا مِمَّنْ دَعَا إِلَى اللَّهِ وَعَمِلَ صَالِحًا وَقَالَ إِنَّنِي مِنَ الْمُسْلِمِينَ ﴿٣٤﴾

35. E mira dhe e keqja nuk mund të barazohen. Kundërpërgjigju përmes asaj që është më e mira, atëherë ai që ka armiqësi mes tij dhe teje, papritmas do të të bëhet mik i ngushtë.

وَلَا تَسْتَوِي الْحَسَنَةُ وَلَا السَّيِّئَةُ ۗ ادْفَعْ بِالَّتِي هِيَ أَحْسَنُ فَإِذَا الَّذِي بَيْنَكَ وَبَيْنَهُ عَدَاوَةٌ كَأَنَّهُ وَلِيٌّ حَمِيمٌ ﴿٣٥﴾

36. Kjo (veti) u dhurohet vetëm atyre që durojnë; dhe kjo u dhurohet vetëm atyre që kanë fat të madh.<sup>5</sup>

وَمَا يُلْقِيهَا إِلَّا الَّذِينَ صَبَرُوا ۗ وَمَا يُلْقِيهَا إِلَّا ذُو حِظٍّ عَظِيمٍ ﴿٣٦﴾

37. Nëse të vjen ndonjë nxitje çrregulluese nga djalli, kërkoja mbrojtjen Allahut. Ai pikërisht është Gjithëdëgjuesi, i Gjithëdijshmi.

وَأَمَّا يَنْزِعَنَّكَ مِنَ الشَّيْطَانِ نَزْعٌ فَاسْتَعِذْ بِاللَّهِ ۗ إِنَّهُ هُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ ﴿٣٧﴾

38. Dhe prej shenjave të Tij janë nata dhe dita, dielli dhe hëna. “Mos i bëni sexhde as diellit e as hënës. Bëjini sexhde Allahut që i krijoi ato, nëse e adhuroni vetëm Atë.”

وَمِنْ آيَاتِهِ الْيَلِيلُ وَالنَّهَارُ وَالشَّمْسُ وَالْقَمَرُ ۗ لَا تَسْجُدُوا لِلشَّمْسِ وَلَا لِلْقَمَرِ وَاسْجُدُوا لِلَّهِ الَّذِي خَلَقَهُنَّ إِن كُنتُمْ إِيَّاهُ تَعْبُدُونَ ﴿٣٨﴾

mos komunikojnë. Jo, përkundrazi, ata u japin lajme të mira njerëzve të dëlirë. Kjo pikërisht është veçantia e Islamit, të cilën fetë e tjera nuk e kanë. Disa komentues pohojnë se kjo ndodh vetëm kur njeriu është në gjendje agonie. Ky mendim nuk është i saktë. Po të ishte kështu, engjëjt si mund t’u thonë: “Jemi miqtë tuaj edhe në këtë botë”?! Lexoni edhe 42:52.

5. Predikimi i së vërtetës (*tablig* ose *da’ve*) sjell edhe vështirësi dhe pengesa për predikuesin. Madje, nganjëherë ai përballlet edhe me persekutime nga kundërshtarët. Andaj, ajeti i jep mësimin e durimit dhe të guximit për të vazhduar përpjekjen e tij, por jo me dhunë, përkundrazi, duke iu përgjigjur së keqes me të mirë.



39. Nëse ata tregohen mendjemëdhenj, (le ta dinë se) ata që janë pranë Zotit tënd, e madhërojnë Atë natë e ditë dhe ata nuk lodhen.

Sexhdeja XII

40. Dhe prej shenjave të Tij është edhe kjo që ti e shikon tokën të tharë, dhe kur Ne zbresim ujin mbi të, ajo fillon të zhdërvillet e të lulëzojë. Sigurisht, Ai që e ringjalli atë, ka për të ringjallur edhe të vdekurit. Sigurisht, Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë.<sup>6</sup>

41. Ata që krijojnë shtrembësi në ajetet Tona, nuk janë të fshehtë nga Ne. A është më i mirë ai që hidhet në zjarr, apo ai që vjen i sigurt Ditën e Kiametit?! Veproni si të doni, Ai sheh mirë gjithçka që bëni.

42. Pa dyshim, (do të ndëshkohen) ata që mohuan këshillën kur ai u erdhi atyre, ndonëse ai qartazi është një Libër i fuqishëm (dhe) i nderuar.

43. Gënjeshtria nuk mund t'i qaset as nga para e as nga mbrapa. Zbritja (e tij) është prej të Urtit, të Lavdishmit.<sup>7</sup>

فَإِنِ اسْتَكْبَرُوا فَالَّذِينَ عِنْدَ رَبِّكَ يُسَبِّحُونَ  
لَهُ بِاللَّيْلِ وَالنَّهَارِ وَهُمْ لَا يَسْمَعُونَ ﴿٣٩﴾

وَ مِنْ آيَاتِهِ أَنْتَ تَرَى الْأَرْضَ خَاشِعَةً  
فَإِذَا أَنْزَلْنَا عَلَيْهَا الْمَاءَ اهْتَزَّتْ وَرَبَتْ  
إِنَّ الْأَرْضَ أَحْيَاهَا لِمُحْيِيَ الْمَوْتَى إِنَّهُ عَلَى  
كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿٤٠﴾

إِنَّ الَّذِينَ يُجَادُونَ فِي آيَاتِنَا لَا يَخْفَوْنَ  
عَلَيْنَا أَفَمَنْ يُلْقَى فِي النَّارِ خَيْرٌ أَمْ مَنْ  
يَأْتِي آمِنًا يَوْمَ الْقِيَامَةِ اعْمَلُوا مَا شِئْتُمْ  
إِنَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ بَصِيرٌ ﴿٤١﴾

إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا بِالذِّكْرِ لَمَّا جَاءَهُمْ  
وَإِنَّهُمْ لَكَاذِبٌ عَازِبُونَ ﴿٤٢﴾

لَا يَأْتِيهِ الْبَاطِلُ مِنْ بَيْنِ يَدَيْهِ وَلَا مِنْ  
خَلْفِهِ ۖ تَنْزِيلٌ مِنْ حَكِيمٍ حَمِيدٍ ﴿٤٣﴾

6. Ajeti pohon se ringjallja e tokës së vdekur ndodh me ujin që zbret prej qiellit dhe se edhe jeta pas vdekjes ngjan pikërisht me këtë fenomen. Pa dyshim, të gjithë do të ringjallen në jetën pas vdekjes, por jetën e vërtetë shpirtërore do ta gëzojnë ata që përfitojnë nga uji qiellor kur u vjen atyre, pra që pranojnë Profetët dhe veprojnë në bazë të mësimëve të tyre. Edhe uji fizik që vjen nga retë bie gjithkund në tokë, por tokat e ngurta dhe djerrë nuk pësojnë ndonjë ndryshim prej shiut. Nga shiu përfiton vetëm ajo tokë që ka elementin e jetës brenda.

7. Kurani është një Libër kaq i mrekullueshëm saqë asnjë nga të vërtetat, parimet dhe idealet e mëdha të shpallura në të, nuk është hedhur dot poshtë as nga mësimet e lashta, as nga shkencat moderne.

44. Ty të thuhet vetëm ajo që u ishte thënë të Dërguarve para teje. Sigurisht Zoti yt është shumë Falës, por Ai ka edhe ndëshkim të rëndë.

45. Dhe po ta kishim bërë këtë (Libër) si një Kuran në një gjuhë të huaj, ata patjetër do të thoshin: Pse nuk janë shpjeguar qartë ajetet e tij? Gjuhë e huaj dhe (Profeti) arab?! Thuaj: Për ata që besuan, ai është udhëzim dhe shërim. Kurse ata që nuk besojnë, kanë barrë në veshët e tyre, andaj ai është i fshehtë para tyre. Pikërisht këta thirren nga një vend i largët.

46. Ne i dhamë Librin edhe Musait; dhe (edhe) në lidhje me të u krijuan kundërshti. Sikur të mos ishte lëshuar (një) fjalë paraprake prej Zotit tënd, do të ishte vendosur mes tyre. Dhe për këtë ata janë në një dyshim shqetësues.

47. Kushdo që bën mirë, e bën për veten e tij, dhe kushdo që bën keq, e bën kundër vetes së tij. Zoti yt kurrë nuk u bën padrejtësi robërve.

48. Tek Ai kthehet dija për Orën. As frutat nuk dalin nga lulet e veta dhe as femrat nuk mbartin dhe as nuk lindin, por vetëm sipas dijes së Tij. Ditën kur Ai do t'i pyesë me zë të lartë: “Ku janë ‘ortakët’ e Mi?”, ata do të thonë: “Po të lajmërojmë se nuk kemi asnjë dëshmitar!”

مَا يَقَالُ لَكَ إِلَّا مَا قَدْ قِيلَ لِلرُّسُلِ مِنْ قَبْلِكَ ۗ إِنَّ رَبَّكَ لَذُو مَغْفِرَةٍ وَذُو عِقَابٍ ۝٤٤

وَلَوْ جَعَلْنَاهُ قُرْآنًا عَجَبِيًّا لَقَالُوا لَوْلَا فُصِّلَتْ آيَاتُهُ ۗ أَعْجَبِيٌّ وَعَرَبِيٌّ ۗ قُلْ هُوَ لِلَّذِينَ آمَنُوا هُدًى وَشِفَاءٌ ۗ وَالَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ فِي آذَانِهِمْ وَقْرٌ وَهُوَ عَلَيْهِمْ عَىٰ ۗ أُولَٰئِكَ يُنَادُونَ مِنْ مَّكَانٍ بَعِيدٍ ۝٤٥

وَلَقَدْ آتَيْنَا مُوسَى الْكِتَابَ فَاخْتَلَفَ فِيهِ ۗ وَلَوْلَا كَلِمَةٌ سَبَقَتْ مِنْ رَبِّكَ لَقُضِيَ بَيْنَهُمْ ۗ وَاللَّهُمَّ لِنَفْسِكَ مِنْهُ مَرْيَبٌ ۝٤٦

مَنْ عَمِلَ صَالِحًا فَلِنَفْسِهِ ۖ وَمَنْ أَسَاءَ فَعَلَيْهَا ۗ وَمَا رَبُّكَ بِظَلَّامٍ لِّلْعَالَمِينَ ۝٤٧

إِنِّي أَنزَلْنَاهُ فِي لَيْلَةِ الْقَدْرِ ۗ وَإِن تَرَىٰ أَضْوَاجًا مِّنْ نُّجُومٍ فَوَجِّهْ لَهَا سُبْحَانَ اللَّهِ عَمَّا يُشْرِكُونَ ۗ إِنَّ رَبَّهُ لَسَمِيعٌ عَلِيمٌ ۗ وَإِن تَرَ صَاعِقًا مِّنْ سَاقِقٍ أَوْ سَاقِقًا مِّنْ سَاقِقٍ فَجَعَلْنَاهُ لَكُم مِّنْ قَبْلِ هَٰذَا آيَةً ۗ وَإِن تَرَ سَاقِقًا مِّنْ سَاقِقٍ فَجَعَلْنَاهُ لَكُم مِّنْ قَبْلِ هَٰذَا آيَةً ۗ وَإِن تَرَ سَاقِقًا مِّنْ سَاقِقٍ فَجَعَلْنَاهُ لَكُم مِّنْ قَبْلِ هَٰذَا آيَةً ۗ وَإِن تَرَ سَاقِقًا مِّنْ سَاقِقٍ فَجَعَلْنَاهُ لَكُم مِّنْ قَبْلِ هَٰذَا آيَةً ۗ

49. Dhe ata do ta humbasin atë që i luteshin deri më parë dhe do ta kuptojnë se nuk kanë më rrugëdalje.

50. Njeriu nuk lodhet duke u lutur për të mirën dhe, po e preku e keqja, bëhet tejet i zhgënjyer, i dëshpëruar.

51. Dhe pas vështirësisë që e prek, nëse e bëjmë të shijojë ndonjë mëshirë Tonën, ai patjetër thotë: “Kjo është për mua, dhe nuk mendoj se do të vijë Ora; dhe (edhe) sikur të kthehem te Zoti im, sigurisht, mua më pret më e mira tek Ai.” Atëherë, Ne patjetër do t’i njoftojmë ata që mohuan për veprat që ata bënë dhe do t’i bëjmë të shijojnë ndëshkim të rëndë.

52. Kur i japim ndonjë të mirë njeriut, ai largohet dhe e mban anën e tij, dhe kur e prek e keqja, fillon të lutet gjerë e gjatë.

53. Thuaj: Më tregoni nëse ky (Kuran) është prej Allahut, por megjithatë ju e keni mohuar atë, kush mund të jetë më i humbur se ai që është i zhytur në kundërshtim të thellë?!

54. Ne patjetër do t’ua tregojmë shenjat Tona edhe në horizonte, edhe në veten e tyre, derisa atyre do t’u bëhet krejt e qartë se ai është i vërteti. A nuk mjafton (fakti) që Zoti yt është Dëshmitar për çdo gjë?!

وَصَلَّ عَنْهُمْ مَا كَانُوا يَدْعُونَ مِنْ قَبْلُ  
وَوَضُّوا مَا لَهُمْ مِنْ مَّحِيصٍ ﴿٤٩﴾

لَا يَسْتُمُّ الْإِنْسَانُ مِنْ دُعَاءِ الْخَيْرِ وَإِنْ  
مَسَّهُ الشَّرُّ فَيُوسِسُ قُوْطٌ ﴿٥٠﴾

وَلَيْنِ أَدَقُّهُ رَحْمَةً مِنَّا مِنْ بَعْدِ ضَرَاءٍ  
مَسَّهُ لِيَقُولَنَّ هَذَا لِي وَمَا أَظُنُّ  
السَّاعَةَ قَائِمَةً ۗ وَلَيْنِ رُجِعْتُ إِلَىٰ رَبِّي  
إِنَّ لِي عِنْدَهُ لَلْحُسْبَىٰ ۚ فَلَنُنَبِّئَنَّ الَّذِينَ  
كَفَرُوا بِمَا عَمِلُوا ۗ وَلَنُدَيِّقُنَّهُمْ مِنْ  
عَذَابٍ غَلِيظٍ ﴿٥١﴾

وَإِذَا أُنْعَمْنَا عَلَى الْإِنْسَانِ أَعْرَضَ وَنَا  
بِجَانِبِهِ ۗ وَإِذَا مَسَّهُ الشَّرُّ فَذُو دُعَاءٍ  
عَرِيضٍ ﴿٥٢﴾

قُلْ أَرَأَيْتُمْ إِنْ كَانَ مِنْ عِنْدِ اللَّهِ نَمَّ  
كَفَرْتُمْ بِهِ مَنْ أَضَلُّ مِمَّنْ هُوَ فِي شِقَاقِ  
بَعِيدٍ ﴿٥٣﴾

سَرَّيْهِمْ أَلَيْتَا فِي الْأَفَاقِ وَفِي أَنْفُسِهِمْ  
حَتَّىٰ يَسْبِغْنَ لَهُمْ أَنَّهُ الْحَقُّ ۗ أَوْلَمْ يَكْفِ  
بِرَبِّكَ أَنَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ شَهِيدٌ ﴿٥٤﴾

55. Dëgjoni! Ata janë në dyshim për takimin me Zotin e tyre! Dëgjoni! Ai është Rrethuesi i çdo gjëje!

أَلَا إِنَّهُمْ فِي مَرِيَةٍ مِّنْ لِّقَاءِ رَبِّهِمْ ۗ أَلَا  
بِئْسَ إِنَّهُ بِكُلِّ شَيْءٍ مُّحِيطٌ ۝۲۵

## Surja 42 – Esh-Shura

Surja Esh-Shura është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka pesëdhjetë e katër ajete.

Ajetet e fundit të sures paraardhëse bënë vërejtje që kur Zoti u dërgon njerëzve bekimin e Tij në formën e Profetit, ata shmangen prej tij, por si rrjedhojë, kur i prek ndonjë e keqe, ata fillojnë t'i bëjnë lutje të gjata Zotit që Ai t'ua largojë të keqen. Pra, Zoti i Madhërishëm u tërhoqi vërejtjen që Ai do t'ua tregonte edhe shenjat që shfaqen në horizonte dhe që janë prova të fuqishme të ligjësisve të natyrës që ka krijuar Ai, gjithashtu, edhe shenjat që gjenden vet në trupin dhe shpirtin e çdo njeriu, si provë e ekzistencës së Tij.

Pas shkurtesave, duke iu drejtuar Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, kjo sure thotë: ashtu siç u erdhi shpallja Profetëve të mëparshëm dhe se popujt e tyre e shpërfillën atë, në të njëjtën mënyrë ty po të dërgohet shpallja si një bekim madhor, por njerëzit materialistë nuk do ta çmojnë atë, pasi ata lakmojnë vetëm begatitë tokësore.

Më pas, në ajetin e 8-të thuhet se Profeti Muhammed<sup>savs</sup> është paralajmëruar për të gjithë botën. Ajeti kur thotë: “Ti do të paralajmërosh amën e vendbanimeve, pra Mekën, dhe këdo që e rrethon atë”, nënkupton që Profeti<sup>savs</sup> është paralajmëruar për të gjithë botën. Më pas, ajeti flet edhe për “ditën e mbledhjes” (*jeumul-xhem'i*). Kjo tregon se ashtu siç Meka është e caktuar të jetë vendi ku do të mbliidhen njerëzit nga e gjithë bota, në të njëjtën mënyrë, një mbledhje tjetër e mbarë njerëzve do të jetë edhe në *ahiret*.

Kështu që, edhe pse u hodhën themelet e mbledhjes a të bashkimit të mbarë njerëzimit përmes ardhjes së Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, Allahu i Madhërishëm e di shumë mirë që njerëzit e botës do ta refuzojnë këtë bekim dhe do të vijnë në të jenë të përçarë si më parë, sepse Allahu i Madhërishëm nuk detyron askënd të bashkohet pranë udhëzimit, se përndryshe, Ai Vetë të gjithë njerëzit do t'i krijonte në një fe të vetme.

Në vijim përsëri thuhet se vetë qëllimi i zbritjes së shpalljes mbi Profetët e mëparshëm ishte që ata të bashkonin njerëzit dhe thuhet se arsyeja kryesore e përçarjes së tyre ishte që ata, pra njerëzit, kishin urrejtje ndaj njëri-tjetrit. Shtrohet pyetja: Pse nuk u bë një gjykim përfundimtar kundër tyre pas mohimit kaq të përsëritur? Për sa kohë që kjo botë vijon të jetë vend sprove për njerëzit, gjykimi përfundimtar i tyre nuk do të bëhet këtu, është kjo përgjigjja që i jep kjo sure kësaj pyetjeje. Pra, ndonëse çdo popull ka marrë gjykimin e tij të përkohshëm brenda afatit të tij të caktuar (*exhel musem-me*), pas tij u shfaq një popull tjetër e pastaj një tjetër e me radhë, andaj, gjykimi përfundimtar i njerëzve do të bëhet në kohën e caktuar e përfundimtare.

Pas kësaj Zoti i Madhërishëm porositi Profetin Muhammed<sup>savs</sup> të mos lëkundej për shkak të kundërshtimeve dhe mosbindjeve të mohuesve, sepse kur Allahu do të

vendosë t'i bashkojë, ata patjetër do të bashkohen. Një profeci madhështore e këtij bashkimi vjen edhe në suren 62, El-Xhumu'a.

Ajetin nr. 24 të kësaj sureje komentuesit shi'itë e përkthejnë në mënyrë të padrejtë, duke e shkëputur tërësisht nga konteksti. Sipas tyre, Allahu e porositi Profetin<sup>savs</sup> të thoshte: “Nuk ju kërkoh ndonjë shpërblim, por shpërbleni të afërmit e mi në vendin tim”, por ky absolutisht nuk është kuptimi i këtij ajeti. Të kërkosh shpërblim për të afërmit e tu është njësoj sikur ta kërkosh për veten tënde. Kuptimi i vërtetë i ajetit në fjalë është: Unë nuk ju kërkoh ndonjë shpërblim, as për vete e as për të afërmit e mi, por ju mos u tregoni të pakujdesshëm ndaj të afërmeve tuaj dhe shpenzoni për nevojat e tyre. Edhe historia dëshmon që Profeti Muhammed<sup>savs</sup> qartazi u ka porositur muslimanëve që pasardhësit e tij të mos llogariten në lëmoshat e tyre.

Pra, tema në kontekst është që duhet të kujdeseni për të varfrit dhe nevojtarët, sidomos për të afërmit, dhe të shpenzoni për nevojat e tyre. Këtu lind pyetja: Pse Allahu i Madhërishëm nuk i ushqen Vetë? Duke iu përgjigjur kësaj pyetjeje thuhet se furnizimi dhe mosfurnizimi ka lidhje me disa urtësi të tjera. Njerëzit sprovohen nganjëherë në skamje, e nganjëherë në kamje. Në kontekst janë përmendur pikërisht këta të fundit që pavarësisht nga pasuria që zotërojnë, nuk kujdesen për të varfrit, madje as për të afërmit e vet.

Më pas, ajeti nr. 30 bën një zbulim befasues, të cilin në kohën e Profetit<sup>savs</sup> asnjë njeri në tërë planetin e Tokës as nuk mund ta imagjinonte dot. Në atë kohë koncepti i njerëzve për universin ishte si një çarçaf me shtatë shtresa, ku janë të kopsitura dielli, hëna, yjet etj.. Askush nuk e mendonte në atë kohë se mund të kishte jetë edhe jashtë Tokës, pra gjallesa që ecin në sipërfaqen e ndonjë planeti tjetër, njësoj si këtu në Tokë. Por çuditërisht ajeti në fjalë e bën këtë zbulim me terma shumë të qartë, madje, duke vijuar temën e bashkimit që thamë më sipër, njofton që jeta në Tokë dhe jeta jashtëtokësore një ditë do të bashkohen, kur të dojë i Plotfuqishmi. Ky bashkim (*xhem'u*) a do të jetë fizik apo me mjete të telekomunikacionit, këtë e di Allahu i Madhërishëm, por sot shkencëtarët po bëjnë përpjekje gjigante për t'u njoftuar për jashtëtokësorët dhe për të kapur qoftë ndonjë sinjal të tyre. Pra, shkencëtarët e sotëm u detyruan të mendojnë për mundësinë e ekzistencës së jetës edhe në ndonjë planet tjetër përveç Tokës.

Kjo sure që titullohet “këshillimi” (*esh-shura*), flet për bashkimin e muslimanëve duke spikatur vetinë e tyre që sa herë që mblidhen për një çështje të rëndësishme, diskutojnë dhe këshillohen me njëri-tjetrin.

Një tjetër ajete, edhe pse i vogël në dukje, provon epërsinë e Kuranit të Shenjtë mbi të gjithë Librat e Shenjtë të mëparshëm. Ajeti thotë se kur dikush keqtrajtohet dhe i bëhet padrejtësi, ai ka të drejtë të hakmerret për aq sa i është bërë padrejtësi, pa i bërë padrejtësi tjetrit nën pushtimin e ndjenjave të hakmarrjes, por, vijon ajeti, nëse gjykon që falja e sjell përmirësimin, le ta falë fajtorin. Në të vërtetë, në disa raste

falja i bën keqbërësit edhe më të guximshëm për të bërë të këqija, andaj, një falje të tillë, Zoti i Madhërishëm në këtë ajet nuk e lejon, kurse falja që nxit përmirësim te gabimtari, gjë që do të tregojnë rrethanat, është ajo që porositet në këtë ajet.

Ajeti nr. 52 flet për lloje të ndryshme të shpalljes, pra të komunikimit me Zotin, duke thënë se asnjë njeri nuk ka fuqi që Allahu të komunikojë me të, përveçse me anë të shpalljes. Dhe nganjëherë shpallja vjen nga mbrapa një “perdeje”, pra folësi nuk bëhet i dukshëm, por zemra e njeriut qartazi e merr mesazhin. Dhe herë i zbret njeriut engjëlli i Zotit në formën e lajmëtarit, i cili ia kumton shpalljen saktësisht atë që Allahu e ka porositur t’ia kumtojë. Më pas, duke iu drejtuar të Dërguarit të Tij<sup>savs</sup>, Allahu i Madhërishëm thotë: Në këtë mënyrë Unë ta kam dërguar shpalljen, duke të dhënë një komunikim jetëdhënës.

Në ajetet e fundit të kësaj sureje përsëritet edhe një herë tema që toka, qiejt dhe gjithçka që gjendet mes tyre janë nën sundimin e Allahut dhe pikërisht tek Allahu do të kthehen të gjitha çështjet.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. *Ha.Mim.* (I Lavdishëm, i Nde-ruar.)

حَمِّمٌ ①

3. *Ain.Sin.Kaf.* (I Gjithëdijshëm, Gjithëdëgjues, i Plotfuqishëm.)

عَسَقٌ ①

4. Kështu Allahu, Mbizotëruesi, i Urti, të shpalli ty dhe atyre që ishin para teje.

كَذَلِكَ يُوحَىٰ إِلَيْكَ وَإِلَى الَّذِينَ مِنْ قَبْلِكَ ۗ اللَّهُ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ①

5. E Atij është gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në tokë, dhe Ai është i Larti, i Madhërishmi.

لَهُ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ ۗ وَهُوَ أَعْلَى الْعَرْشِ عَظِيمٌ ①

6. Mundet që qiejt të çahen me (urdhrin e të Pushtetshmit) sipër,<sup>1</sup> ndërkohë engjëjt duke madhëruar dhe duke lavdëruar Zotin e tyre, t'i kërkojnë falje për ata që janë në tokë. Dëgjoni! Pikërisht Allahu është Falësi, Mëshirëbërësi.<sup>2</sup>

تَكَادُ السَّمَوَاتُ يَتَّقَطْنَ مِنْ فَوْقِهِنَّ ۗ وَالْمَلَائِكَةُ يُسَبِّحُونَ بِحَمْدِ رَبِّهِمْ وَيَسْتَغْفِرُونَ لِمَنْ فِي الْأَرْضِ ۗ أَلَا إِنَّ اللَّهَ هُوَ الْعَفُورُ الرَّحِيمُ ①

7. Allahu është Mbikëqyrës edhe për ata që zgjedhin miq të tjerë përveç Tij, kurse ti nuk je mbrojtësi i tyre.

وَالَّذِينَ اتَّخَذُوا مِنْ دُونِهِ أَوْلِيَاءَ ۗ اللَّهُ حَفِيفٌ عَلَيْهِمْ ۗ وَمَا أَنْتَ عَلَيْهِمْ بِوَكِيلٍ ①

1. Parafjala arabe “*min*” që është në këtë ajet jep edhe kuptimin e shkakut, kurse fuqia “sipër” qiellit është ajo e Zotit, andaj, një kuptim i këtij ajeti është që qielli mund të çahet për shkak të urdhrit që i vjen nga Lart, nga Zoti i Plotfuqishëm.

2. Banorët e Tokës kur pësojnë gjëma të tmerrshme prej qiellit, engjëjt i luten Zotit për njerëzit e sinqertë dhe të pastër që jetojnë në Tokë duke i kërkuar falje për ta. Engjëjt vetë janë të pafajshëm, por kërkojnë falje për robërit e Zotit.



8. Dhe kështu Ne të shpallëm ty një Kuran në gjuhën arabe, që të alarmosh Amën e vendbanimeve dhe ata që janë përreth saj, dhe t'i alarmosh për ditën e mbledhjes në të cilën nuk ka dyshim. Një grup do të jetë në xhenet dhe një grup do të jetë në zjarrin flakërues.<sup>3</sup>

9. Po të donte Allahu, do t'i bënte ata një popull të vetëm, por Ai kë të dojë e fut nën mëshirën e Tij. Kurse keqbërësit nuk do të kenë asnjë mik dhe asnjë ndihmës.

10. A kanë zgjedhur miq të tjerë përveç Tij?! Kurse pikërisht Allahu është Miku dhe është Ai që ringjall të vdekurit, po kështu, pikërisht është Ai i Plotfuqishëm për çdo gjë.

11. Për çdo gjë që ju kundërshtoni, gjykimi i saj është tek Allahu. Ky është Allahu, Zoti im; tek Ai mbështetem dhe tek Ai kthehem i përlur.

12. Krijuesi i qiejve dhe i tokës nga asgjëja. Ai krijoi për ju çifte nga mesi juaj, po kështu edhe çifte të bagëtive. Ai ju shton në të (pra, në tokë). Asgjë nuk është si Ai.<sup>4</sup> Dhe Ai është

وَكَذَلِكَ أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ قُرْآنًا عَرَبِيًّا تَتَذَكَّرَ  
أَمْرَ الْقُرَىٰ وَمَنْ حَوْلَهَا وَتُنذِرَ يَوْمَ الْجَمْعِ  
لَا رَيْبَ فِيهِ ۗ فَرِيقٌ فِي الْجَنَّةِ وَفَرِيقٌ فِي  
السَّعِيرِ ①

وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ لَجَعَلَهُمْ أُمَّةً وَاحِدَةً وَلَكِنْ  
يُدْخِلُ مَنْ يَشَاءُ فِي رَحْمَتِهِ ۗ وَالظَّالِمُونَ  
مَا لَهُمْ مِنْ وَلِيٍّ وَلَا نَصِيرٍ ①

أَمْ اتَّخَذُوا مِنْ دُونِهِ آلِيَاءَ ۗ قَالَ اللَّهُ هُوَ  
الْوَالِيُّ وَهُوَ يُحْيِي الْمَوْتَىٰ ۗ وَهُوَ عَلَىٰ كُلِّ  
شَيْءٍ قَدِيرٌ ①

وَمَا اخْتَلَفْتُمْ فِيهِ مِنْ شَيْءٍ فَحُكْمُهُ إِلَىٰ  
اللَّهِ ۗ ذَلِكُمْ اللَّهُ رَبِّي عَلَيْهِ تَوَكَّلْتُ ۗ وَإِلَيْهِ  
أُنِيبُ ①

فَاطِرُ السَّمٰوٰتِ وَالْاَرْضِ ۗ جَعَلَ لَكُمْ مِنْ  
اَنْفُسِكُمْ اَزْوَاجًا ۗ وَ مِنَ الْاَنْعَامِ اَزْوَاجًا ۗ  
يَذَرُوْكُمْ فِيْهِ ۗ لَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ ۗ وَهُوَ

3. Edhe epoka e një profeti është e ngjashme me Orën ose Kiametin. Ashtu siç në Ditën e Gjykimit njerëzit do të ndahen kryesisht në dy grupe, në të njëjtën mënyrë, edhe në kohën e një profeti, ata ndahen në dy grupe.

4. Fjalët “asgjë nuk është si Ai” largojnë çdo keqkuptim të mundshëm që mund të lindte nga pjesa e parë e ajetit ku thuhet se Ai ka krijuar çdo gjë në çifte. Pra, mund të lindte pyetja – Po Vetë Ai, a ka nevojë për çift? Asgjë nuk është si Zoti, andaj është e pamundur të konceptohet diçka si Ai që të mund t'i bëhej çift. Po kështu, në Kuranin e Shenjtë në shumë ajete janë përmendur atributet e Zotit të cilat Ai ia ka dhuruar edhe njeriut. Për shembull, tha: Zoti dëgjon, sheh, flet, vendoset në fron, etj.. Për të larguar çdo dyshim që mund të çonte dikë në

Gjithëdëgjuesi, Gjithëshikuesi.<sup>5</sup>

السَّمِيعُ الْبَصِيرُ ⑩

13. Ai i ka çelësat e qiejve e të tokës. Atij që do Ai ia shton të mirat dhe, (edhe) ia pakëson. Sigurisht, Ai është i Gjithëdijshëm për çdo gjë.

لَهُ مَقَالِيدُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ۚ يَبْسُطُ  
الرِّزْقَ لِمَن يَشَاءُ وَيَقْدِرُ ۗ إِنَّهُ بِكُلِّ شَيْءٍ  
عَلِيمٌ ⑩

14. Ai ju dha porosinë në fe, ato që ia kishte porositur Nuhut. Dhe ajo që të kemi shpallur ty dhe që ia kemi porositur Ibrahimit, Musait dhe Isait: Qëndroni në fenë (Time) dhe mos u përçani në lidhje me të. Është e rëndë për idhujtarët ajo për të cilën ju i ftoni ata. Allahu zgjedh për Vetën e Tij kë të dojë dhe e udhëzon atë që kthehet i përrulur tek Ai.

شَرَعَ لَكُم مِّنَ الدِّينِ مَا وَصَّى بِهِ نُوحًا  
وَآلِدَيْ أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ وَمَا وَصَّيْنَا بِهِ  
إِبْرَاهِيمَ وَمُوسَى وَعِيسَى أَنْ أَقِيمُوا الدِّينَ  
وَلَا تَتَفَرَّقُوا فِيهِ ۗ طَبَعَ عَلَى الْمَشْرِكِينَ مَا  
تَدْعُوهُمْ إِلَيْهِ ۗ اللَّهُ يَجْتَبِي إِلَيْهِ مَن يَشَاءُ  
وَيَهْدِي إِلَيْهِ مَن يُنِيبُ ⑪

15. Ata u përçanë vetëm duke u rebeluar ndaj njëri-tjetrit pasi u erdhi dija. Sikur të mos ishte lëshuar (një) fjalë paraprake prej Zotit tënd për një afat të caktuar, do të ishte vendosur për ta. Dhe, pa dyshim, ata që trashëguan Librin pas tyre, janë në një dyshim shqetësues rreth tij.

وَمَا تَفَرَّقُوا إِلَّا مِنْ بَعْدِ مَا جَاءَهُمُ الْحُكْمُ  
بَعِيًّا بَيْنَهُمْ ۗ وَلَوْلَا كَلِمَةٌ سَبَقَتْ مِنْ رَبِّكَ  
إِلَىٰ أَجَلٍ مُّسَمًّى لَّفُضِّضَ بَيْنَهُمْ ۗ وَإِنَّ  
الَّذِينَ أُورِثُوا الْكِتَابَ مِنْ بَعْدِهِمْ لَفِي  
شَكٍّ مِّنْهُ مُرِيبٍ ⑫

16. Prandaj, për këtë ftoji (ata) dhe qëndro i palëkundur siç je urdhëruar, dhe mos i ndiq dëshirat e tyre. Thuaj:

فَلِذَلِكَ فَادُعْ ۚ وَاسْتَقِمْ كَمَا أَمَرْتُ ۚ وَلَا  
تَتَّبِعْ أَهْوَاءَهُمْ ۗ وَقُلْ أَمِنْتُ بِمَا أَنْزَلَ

përfytyrimin e Zotit si njeri, Ai tha: “asgjë nuk është si Ai”. Andaj, njeriu mund ta perceptojë Zotin vetëm në bazë të kapacitetit të tij, por Zoti është i Pakufishëm, i Pangjashëm me asgjë dhe është përtej kapacitetit perceptues të njeriut.

5. Në kohën e Profetit Muhammed<sup>saws</sup>, njerëzit natyrisht që dinin se shtazët janë në çifte, madje dinin edhe për disa pemë që ato janë në çifte, por kurrsesi nuk mund të dinin se Allahu i Madhërishëm çdo gjë të këtij universi e ka krijuar në çift. Në kohët tona është provuar që edhe grimcat janë në çifte. [Shikoni edhe ajetet 36:37; 43:13]. Së dyti, ky ajet flet edhe për shtimin e njerëzve siç shtohen bimët, gjë që gjithashtu tregon se jeta zuri fill me bimësi. Ky ajet përdor foljen (*dhere'e*), por një ajet tjetër i Kuranit e sqaron edhe më shumë këtë temë duke thënë: “Allahu ju rriti prej tokës porsì bimët” (Nuh 71:18).

“Besova në gjithçka që Allahu ka zbritur nga Libri dhe jam urdhëruar të bëj drejtësi mes jush. Allahu është Zoti ynë dhe Zoti juaj. Ne kemi veprat tona e ju keni veprat tuaja. Nuk ka grindje mes nesh e jush. Allahu do të na mbledhë Ne, dhe tek Ai është kthimi.”

17. Dhe ata që grinden në lidhje me Allahun pasi (një numër i madh njerëzish) e kanë pranuar, argumenti i tyre është i pavlefshëm pranë Zotit të tyre dhe ata do të marrin zemërimin dhe do të kenë ndëshkim të rëndë.

18. Allahu është Ai që zbriti Librin me të vërtetën, dhe peshoren.<sup>6</sup> Dhe çfarë mund të të bindë ty se ndoshta Ora është afuar!

19. E kërkojnë me nxitim (Orën) pikërisht ata që nuk besojnë në të, kurse ata që besuan, frikësohen prej saj dhe e dinë që ajo është e vërtetë. Dëgjoni! Ata që grinden në lidhje me Orën, janë në një devijim të thellë.

20. Allahu është shumë i Butë ndaj robërve të Tij. Ai i jep kujt të dojë dhe Ai është i Forti, Mbizotëruesi.

اللَّهُ مِنْ كِتَابٍ ۚ وَأَمَرْتُ لِأَعْدِلَ بَيْنَكُمُ ۖ  
اللَّهُ رَبُّنَا وَرَبُّكُمْ ۖ لَنَا أَعْمَالُنَا وَلَكُمْ  
أَعْمَالُكُمْ ۖ لَا حِجَّةَ بَيْنَنَا وَبَيْنَكُمُ ۖ اللَّهُ  
يَجْمَعُ بَيْنَنَا ۚ وَالْإِيَّاهُ الْمَصِيرُ ۝

وَالَّذِينَ يَحْتَجُّونَ فِي اللَّهِ مِنْ بَعْدِ مَا  
اسْتَجَبَ لَهُمْ حُجَّتُهُمْ دَاحِضَةً عِنْدَ رَبِّهِمْ  
وَعَلَيْهِمْ غَضَبٌ ۚ وَ لَهُمْ عَذَابٌ شَدِيدٌ ۝

اللَّهُ الَّذِي أَنْزَلَ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ وَالْمِيزَانَ ۖ  
وَمَا يُدْرِيكَ لَعَلَّ السَّاعَةَ قَرِيبٌ ۝

يَسْتَعْجِلُ بِهَا الَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ بِهَا ۚ  
وَالَّذِينَ آمَنُوا مُشْفِقُونَ مِنْهَا ۗ وَيَعْلَمُونَ  
أَنَّهَا الْحَقُّ ۖ آلَا إِنَّ الَّذِينَ يَمَارُونَ فِي  
السَّاعَةِ لَفِي ضَلَالٍ بَعِيدٍ ۝

اللَّهُ لَطِيفٌ بِعِبَادِهِ ۖ يَرْزُقُ مَنْ يَشَاءُ ۚ وَهُوَ  
الْقَوِيُّ الْعَزِيزُ ۝

6. Zoti ka zbritur dy gjëra të rëndësishme për udhëzimin dhe dobinë e njeriut: (a) “Librin”, d.m.th. ligjet e Sheriatit; (b) “Peshoren”, d.m.th. standardet me të cilat vlerësohen dhe gjykojnë veprimet njerëzore. Ose, “Peshorja” mund të nënkuptojë aftësinë që Zoti i ka dhënë njeriut, me të cilën ai mund të bëjë dallimin midis së drejtës dhe së gabuarës. Në fakt, në këtë jetë (dhe aq më tepër në jetën tjetër) të gjitha veprimet njerëzore peshohen në peshore Hyjnore. “Peshorja” mund t’i referohet edhe vetë Kuranit, sepse edhe Kurani përbën një kriter të pagabueshëm për të gjykuar se çfarë është e drejtë dhe çfarë është e gabuar.

21. Ai që dëshiron të korrat e *ahiretit*, Ne ia shtojmë të korrat e tij, dhe ai që dëshiron të korrat e kësaj bote, prej saj ia japim atij, por ai nuk do të ketë ndonjë pjesë në ahiret.

مَنْ كَانَ يُرِيدُ حَرْثَ الْآخِرَةِ نَزَدَكَ فِي حَرْثِهِ ۚ وَمَنْ كَانَ يُرِيدُ حَرْثَ الدُّنْيَا نُؤْتِهِ مِنْهَا وَمَا لَهُ فِي الْآخِرَةِ مِنْ نَصِيبٍ ﴿٢١﴾

22. A kanë ortakë ata që u lëshuan porosi të atilla në fe, që Allahu nuk i ka urdhëruar?! Po të mos ishte fjalë paraprake për (mënyrën e) gjykimit, menjëherë do të vendosej për ta. Sigurisht, për keqbërësit ka një ndëshkim të dhimbshëm.

أَمْ لَهُمْ شُرَكَاءُ شَرَعُوا لَهُمْ مِنَ الدِّينِ مَا لَمْ يَأْذَنْ بِهِ اللَّهُ ۗ وَلَوْلَا كَلِمَةُ الْفَصْلِ لَفُضِيَ بَيْنَهُمْ ۗ وَإِنَّ الظَّالِمِينَ لَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿٢٢﴾

23. Ti do t'i shohësh keqbërësit që do të frikësohen për shkak të asaj që punuan, ndërkohë, ajo do t'u bjerë atyre. Dhe ata që besuan dhe bënë të mira do të jenë në kopshtet e xhenetit; ata do të kenë gjithçka që do të dëshirojnë pranë Zotit të tyre. Ky pikërisht është bekimi madhështor.

تَرَى الظَّالِمِينَ مُشْفِقِينَ فَمَا كَسَبُوا وَهُمْ وَاقَعُ بِهِمْ ۗ وَالَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ فِي رَوْضَاتِ الْجَنَّاتِ لَهُمْ مَا يَشَاءُونَ عِنْدَ رَبِّهِمْ ۗ ذَلِكَ هُوَ الْفَضْلُ الْكَبِيرُ ﴿٢٣﴾

24. Kjo është ajo që Allahu ua ka dhënë si lajm të mirë robërve të Tij, të cilët besuan dhe bënë të mira. Thuaj: “Nuk ju kërkoj ndonjë shpërblim për këtë, përveçse të keni dashurinë e të afërmve (për njëri-tjetrin).” Ai që gjallëron një vepër të mirë, Ne do t'i shtojmë të mirën në të. Pa dyshim, Allahu është shumë Falës, shumë Mirënjohës.

ذَلِكَ الَّذِي يُبَشِّرُ اللَّهُ عِبَادَهُ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ ۗ قُلْ لَا أَسْأَلُكُمْ عَلَيْهِ أَجْرًا إِلَّا الْمَوَدَّةَ فِي الْقُرْبَىٰ ۗ وَمَن يَقْتَرِفْ حَسَنَةً نَّزِدْ لَهُ فِيهَا حُسْنًا ۗ إِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ شَكُورٌ ﴿٢٤﴾

25. A thonë se ai ka trilluar gënjeshtër mbi Allahun?! Po të donte Allahu, do të ta vuloste zemrën ty; Allahu fshin të pavërtetën dhe vendos të vërtetën përmes fjalëve të Tij. Sigurisht, Ai

أَمْ يَقُولُونَ افْتَرَىٰ عَلَى اللَّهِ كَذِبًا ۚ فَإِن يَشَاءِ اللَّهُ يَخْتِمْ عَلَى قَلْبِكَ ۗ وَيَمْحُ اللَّهُ الْبَاطِلَ وَيُحِقُّ الْحَقَّ بِكَلِمَاتِهِ ۗ إِنَّهُ عَلِيمٌ

është i Gjithëdijshëm për çdo gjë që mbajnë kraharorët.

بَدَاتِ الصُّدُورِ ⑩

26. Dhe është Ai që u pranon pendesën robërve të Tij<sup>7</sup> dhe ua fal mëkatet, dhe Ai e di atë që bëni.

وَهُوَ الَّذِي يَقْبَلُ التَّوْبَةَ عَنْ عِبَادِهِ وَيَعْفُو عَنِ السَّيِّئَاتِ وَيَعْلَمُ مَا تَفْعَلُونَ ⑪

27. Dhe atyre që besuan dhe (që) bënë të mira, u pranon (lutjet) dhe i shton ata me bekimin e Tij. Kurse mohuesit do të kenë ndëshkim të rëndë.

وَيَسْتَجِيبُ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ وَيَزِيدُهُمْ مِنْ فَضْلِهِ ⑫ وَالْكَافِرُونَ لَهُمْ عَذَابٌ شَدِيدٌ ⑬

28. Po të kishte shtuar Allahu të mirat për robërit e Tij, ata patjetër do të rebeloheshin në tokë, por Ai dërgon me masë atë që dëshiron. Sigurisht, për robërit e Tij Ai është i Gjithinformuar, Gjithëshikues.<sup>8</sup>

وَلَوْ بَسَطَ اللَّهُ الرِّزْقَ لِعِبَادِهِ لَبَغَوْا فِي الْأَرْضِ وَلَكِنْ يُنَزِّلُ بِقَدَرٍ مَّا يَشَاءُ ⑭ إِنَّهُ بِعِبَادِهِ خَبِيرٌ بَصِيرٌ ⑮

29. Dhe është Ai që dërgon shiun, pasi ata të dëshpërohen, dhe përhap mëshirën e Tij. Pikërisht Ai është Miku, i Lavdishmi.

وَهُوَ الَّذِي يُنَزِّلُ الْغَيْثَ مِنْ بَعْدِ مَا قَنَطُوا وَيَنْشُرُ رَحْمَتَهُ ⑯ وَهُوَ الْوَلِيُّ الْحَمِيدُ ⑰

30. Prej shenjave të Tij janë edhe krijimi i qiejve dhe i tokës, si dhe gjithçka prej gjallesave që Ai përhap në to. Dhe, kur të dojë, Ai është i Plotfuqishëm t'i bashkojë ato.<sup>9</sup>

وَمِنْ آيَاتِهِ خَلْقُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا مِنْ دَابَّةٍ ⑱ وَهُوَ عَلَى جَمْعِهِمْ عَلِيمٌ ⑲ إِذَا يَشَاءُ قَدِيرٌ ⑳

7. Për të ditur një domethënie se çfarë do të thotë të jesh rob i Allahut, lexoni shënimin te 1:5.

8. Nëse do të donte Allahu, Ai do t'i jepte me bollëk çdo njeriu, që të mos mbetej askush i varfër, por duket se shpërndarja e pasurisë është bërë në atë mënyrë që disa kanë më shumë, e disa më pak, dhe në të dyja rastet, njerëzit janë në sprovë. Disa robër devijojnë nga rruga e drejtë për shkak të bollëkut të të mirave, kurse disa të tjerë për shkak të skamjes. Për këta të fundit, i Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> një herë tha: “Ka mundësi që varfëria të çojë njeriun në mohim.” (Xhelaluddin es-Sujuti, “El-Xhamius-sagir fi ehadithil-beshir en-nedhir”, botues: “El-Kutub el-’ilmijje”, Bejrut 2004, fq. 387, hadithi nr. 6199). Ndoshta kjo i referohet edhe komunizmit, që përfundimisht shkakton mohimin e Zotit.

9. Ajeti flet edhe për jashtëtokësorët. Lexoni shpjegimin në parathënien e sures.

31. Çdo fatkeqësi që ju godet, vjen për shkak të asaj që duart tuaja kanë punuar, ndërkohë Ai ju fal shumë (gabime).<sup>10</sup>

وَمَا أَصَابَكُمْ مِنْ مُصِيبَةٍ فَمَا كَسَبَتْ  
أَيْدِيكُمْ وَيَعْفُوا عَنْ كَثِيرٍ ﴿٣١﴾

32. Ju nuk mund ta mposhtni dot në tokë (Allahun) dhe përveç Allahut ju nuk keni asnjë Mik dhe asnjë Ndihmës.

وَمَا أَنْتُمْ بِمُعْجِزِينَ فِي الْأَرْضِ ۗ وَمَا  
لَكُمْ مِنْ دُونِ اللَّهِ مِنْ وَلِيٍّ وَلَا نَصِيرٍ ﴿٣٢﴾

33. Prej shenjave të Tij janë edhe anijet (e mëdha) porsì malet që lundrojnë në det.

وَمِنْ آيَاتِهِ الْجَوَارِ فِي الْبَحْرِ كَالْأَعْلَامِ ﴿٣٣﴾

34. Po të dojë Ai, mund të ndalë erën, që ato të mbeten të palëvizshme në sipërfaqen e tij. Pa dyshim, në të ka shenja për çdo të duruar (dhe) mirënjohës.<sup>11</sup>

إِنْ يَشَأْ يُسْكِنِ الرِّيحَ فَيَظْلَلْنَ رَوَاكِدَ  
عَلَى ظَهْرِهِمْ ۗ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِكُلِّ صَبَّارٍ  
شَكُورٍ ﴿٣٤﴾

35. Ose Ai t'i shkatërrojë (anijet) për shkak të asaj që kanë punuar (udhëtarët e tyre), por Ai fal shumë (gabime).

أَوْ يُوقِفَهُنَّ بِمَا كَسَبُوا وَيَعْفُ عَنْ كَثِيرٍ ﴿٣٥﴾

10. Njeriu nuk mund t'ia kërkojë drejtësinë Zotit bazuar tek aftësitë e tij personale, pasi gjithçka që ka ai, ia ka dhuruar Zoti. Sipas Kuranit, të gjitha cilësitë e Zotit janë prej Sunduesi, andaj, Ai ashtu siç mund ta ndëshkojë njeriun për mëkatin e tij, edhe mund ta falë atë. Pra, sundimi i Tij vepron në të dyja aspektet, ashtu siç duhet të jetë Sunduesi i Ditës së Gjykimit. Zoti po të ndëshkonte njeriun për çdo mëkat, njeriu nuk do të kishte asnjë shpëtim. Zoti në shumicën e rasteve ia fal mëkatet njeriut, dhe ndonjëherë e ndëshkon për ta qortuar, në mënyrë që ai të ndërgjegjësohet nëse është i shkujdesur. Po kështu, ky ajet pohon se brenga në të cilën njeriu e humb durimin tërësisht dhe pikëllohet aq shumë saqë edhe jeta i bëhet e vështirë, vjen për shkak të veprimeve të vetë njeriut, si pasojë e veprave ose e dëshirave të tij. Shpëtimi nga kjo lloj brenge është që ai t'i druhet Zotit dhe të dijë se jeta e kësaj bote është shumë e shkurtër, dhe djalli i rri në pritë dhe përpiqet vazhdimisht që ai të brengoset dhe të largohet prej Zotit. Po kështu, edhe vetja e tij e mashtron duke thënë se do të jetosh gjatë dhe ke shumë kohë për ta gjetur zgjidhjen te Zoti. Kjo e largon atë nga Zoti dhe ai mbetet pa e hedhur hapin drejt mirësisë.

11. Ajetet 33 – 34: Një ndër shenjat e Allahut të Madhërishëm që ajeti nr. 33 rendit janë anijet që janë të mëdha sa male. Dihet që në kohën e Profetit Muhammed<sup>savs</sup> vepronin anijet e vogla me vela. Prandaj, ky ajet parashikoi një nga zhvillimet e kohëve tona kur shohim anije të tilla gjigante.

36. Dhe që të dinë ata që grinden në lidhje me shenjat Tona (se) nuk kanë vend shpëtimi.

وَيَعْلَمَ الَّذِينَ يُجَادِلُونَ فِي آيَاتِنَا مَا لَهُمْ  
مِنْ مَحِيصٍ ﴿٣٦﴾

37. Çdo gjë që ju është dhënë juve është përfitim i përkohshëm i jetës së kësaj bote. Kurse ajo që është tek Allahu është më e mirë dhe më e qëndrueshme për ata që besuan dhe (që) mbështeten te Zoti i tyre;

فَمَا أُوتِيتُمْ مِنْ شَيْءٍ فَمَتَاعُ الْحَيَاةِ  
الدُّنْيَا ۗ وَمَا عِنْدَ اللَّهِ خَيْرٌ وَأَبْقَى لِلَّذِينَ  
آمَنُوا وَعَلَىٰ رَبِّهِمْ يَوْمَئِذٍ ﴿٣٧﴾

38. që ruhen nga mëkatet e mëdha, nga imoralitetet, dhe falin kur zemërohen;

وَالَّذِينَ يَجْتَنِبُونَ كَبِيرَ الْإِثْمِ  
وَالْفَوَاحِشَ وَإِذَا مَا غَضِبُوا هُمْ  
يَغْفِرُونَ ﴿٣٨﴾

39. që i përgjigjen me pohim thirrjes së Zotit të tyre, kryejnë namazin, çështjen e tyre e zgjidhin me këshillim të ndërsjellë, japin prej asaj që Ne u kemi dhënë;<sup>12</sup>

وَالَّذِينَ اسْتَجَابُوا لِرَبِّهِمْ وَأَقَامُوا  
الصَّلَاةَ ۗ وَأَمْرُهُمْ شُورَىٰ بَيْنَهُمْ ۗ وَهُمْ  
رَزَقْنَاهُمْ يُنْفِقُونَ ﴿٣٩﴾

40. dhe që kur përballen me rebelimin padrejtësisht, hakmerren.

وَالَّذِينَ إِذَا أَصَابَهُمُ الْبَغْيُ هُمْ  
يَنْصَرُونَ ﴿٤٠﴾

12. Ajeti parashtron parimin se muslimanët duhet të kenë organin këshillimor ku duhen diskutuar çështjet e rëndësishme. Në situata të ndryshme Profeti Muhammed<sup>savs</sup> thirrte sahabët ose njerëz me përvojë për t'u këshilluar, më pas merrte vendimin, të cilin e pranonin të gjithë besimtarët. Pas tij, edhe Kalifi i Profetit ose udhëheqësi i qeverisjes i *umetit* të muslimanëve është i obliguar të këshillohet me organin këshillimor, para se të marrë vendime të rëndësishme. Përveç kësaj, të këshillohesh është një parim i artë, i cili të sjell edhe ndihmën dhe bekimin e Zotit. Njeriu që këshillohet, nuk mbetet pishman. Kurse vetëpëlpimi dhe mburrja janë sëmundje të tilla që e kanë bërë të mallkuar edhe djallin, dhe që e shkatërrojnë edhe njeriun. Nuk është e mundur për njeriun të jetë i gjithanshëm në mënyrë të përsosur që vetëm me kokën e tij të arrijë të bëjë gjithçka dhe të ketë edhe sukses. Madje, shpesh edhe njerëzit me përvojë detyrohen të pendohen vetëm për shkak se nuk këshillohen para se të bëjnë një punë të rëndësishme. Edhe në jetën personale, njeriu nuk duhet të shkatërrojë veten duke u bregosur nga dështimi i së tashmes, dhe as nuk duhet ta ndëshkojë veten duke kujtuar pakujdesitë e së kaluarës, por duhet t'i kërkojë ndihmë Zotit përmes namazit, të këshillohet dhe të kërkojë zgjidhjen e problemeve për të vazhduar jetën përpara.

41. Dëmshtëpërblimi i së keqes është aq sa është e keqja, por kush fal (fajtorin) dhe përmirëson, shpërblimi i tij është mbi Allahun. Pa dyshim, Ai nuk i do të padrejtët.<sup>13</sup>

وَجَزَا سَيِّئَةً سَيِّئَةً مِّثْلَهَا ۗ فَمَنْ عَفَا  
وَأَصْلَحَ فَاجْرُهُ عَلَى اللَّهِ ۗ إِنَّهُ لَا يُحِبُّ  
الظَّالِمِينَ ﴿٤١﴾

42. Dhe ata që hakmerren pasi u është bërë padrejtësi, nuk kanë faj.

وَلَمَنِ اتَّصَرَ بَعْدَ ظُلْمِهِ فَأُولَٰئِكَ مَا  
عَلَيْهِمْ مِنْ سَبِيلٍ ﴿٤٢﴾

43. Fajin e kanë ata që u bëjnë padrejtësi njerëzve dhe rebelohen në tokë pa të drejtë. Të tillët do të kenë ndëshkim të dhimbshëm.

إِنَّمَا السَّبِيلُ عَلَى الَّذِينَ يَظْلِمُونَ النَّاسَ  
وَيَبْغُونَ فِي الْأَرْضِ بِغَيْرِ الْحَقِّ ۗ أُولَٰئِكَ  
لَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿٤٣﴾

44. Ai që duron dhe fal, (ta dijë) se këto janë virtyte shumë të larta.

وَلَمَنْ صَبَرَ وَغَفَرَ ۗ إِنَّ ذَلِكَ لَمِنْ عَزْمِ  
الْأُمُورِ ﴿٤٤﴾

45. Atë të cilin Allahu e cilëson të devijuar, pas kësaj ai nuk ka më ndonjë ndihmës. Ti do t'i shohësh të padrejtët kur ata do të jenë duke parë ndëshkimin, do të thonë: “A ka ndonjë rrugëdalje për t'i ikur (kësaj)!”

وَمَنْ يُضِلِلِ اللَّهُ فَمَا لَهُ مِنْ وَادٍ ۖ مِنْ بَعْدِهِ  
وَتَرَى الظَّالِمِينَ لَمَّا رَأَوُا الْعَذَابَ يَقُولُونَ  
هَلْ إِلَىٰ مَرَدٍّ مِنْ سَبِيلٍ ﴿٤٥﴾

46. Dhe do t'i shohësh që ata do të dalin përpara atij (ndëshkimi)

وَتَرَاهُمْ يُعْرَضُونَ عَلَيْهَا خَشِيعِينَ مِنَ الدَّلِّ  
يُنظَرُونَ مِنْ طَرَفٍ حَفِيٍّ ۗ وَقَالَ الَّذِينَ

13. Ky ajet tregon se mësimi i Kuranit për ne nuk është që në çdo rast, pa arsye, të tolerojmë të keqen dhe të mos dënojmë të ligjtë dhe mizorët, por që ne ta shqyrtojmë situatën për të parë nëse ajo na bën thirrje për falje apo për dënim. Pra, duhet të zgjedhim alternativën që me të vërtetë shkon në favor të fajtorit dhe njerëzve të tjerë. Disa herë fajtori edhe pendohet nëse i falet fajti, por mundet që nga falja ai të marrë më shumë guxim për ta përsëritur gabimin. Kështu që, Zoti i Lartësuar thotë që nuk duhet ta bëni zakon që gjithmonë të falni verbërisht. Por, duhet ta shqyrtoni mirë situatën për të parë se ku qëndron mirësia e vërtetë: në falje apo në ndëshkim. Kurani i Shenjtë ka vënë kushtin e përshtatshmërisë për realizimin e çdo virtyti dhe nuk ka pranuar asnjë virtyt që realizohet pa të. Islami nuk anon as nga njëri skaj që thotë “sy për sy, dhëmb për dhëmb” (Dhiata e Vjetër, Eksodi 21:23-27), e as nga skaji tjetër që thotë “në qoftë se dikush të qëllon mbi faqen e djathtë, ktheja dhe tjetrën” (Dhiata e Re, Mateu 5:38-39), por ndjek rrugën e mesme dhe praktike.



kokulur për shkak të poshtërimit, duke parë me një shikim të fshehtë. Dhe ata që besuan, do të thonë: “Humbësit e vërtetë janë ata që Ditën e Kiametit i shkaktuan humbje vetvetes dhe familjeve të tyre!” Dëgjoni! Të padrejtët do të jenë në një ndëshkim që mbetet.

47. Ata nuk do të kenë miq që t'i ndihmojnë, përveç Allahut. Dhe atë që Allahu e cilëson të devijuar, ai nuk ka më ndonjë rrugëdalje.

48. Përgjigjuni me pohim Zotit tuaj përpara se t'ju vijë dita për të cilën Allahu ka vendosur që nuk ka kthim pas. Atë ditë, ju nuk do të keni asnjë strehë dhe nuk do të keni asnjë mundësi refuzimi.

49. E nëse ata largohen, atëherë Ne nuk të kemi dërguar ty si mbikëqyrës ndaj tyre. Detyra jote është vetëm kumtimi i mesazhit. Njëmend, kur Ne e bëjmë njeriun të shijojë ndonjë mëshirë Tonën, ai kënaqet me të, dhe kur e godet ndonjë fatkeqësi për shkak të asaj që vetë duart e tij e sollën, atëherë (ky) njeri bëhet tepër mosmirënjohës.

50. I Allahut është sundimi i qiejve dhe i tokës. Ai krijon çfarë të dojë. Kujt të dojë i dhuron vajza e kujt të dojë i dhuron djem.

أَمْوَا إِنَّ الْخُسِرِينَ الَّذِينَ خَسِرُوا  
أَنْفُسَهُمْ وَأَهْلِيَهُمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ ۗ أَلَا إِنَّ  
الظَّالِمِينَ فِي عَذَابٍ مُّقِيمٍ ﴿٤٧﴾

وَمَا كَانَ لَهُمْ مِنْ أَوْلِيَاءٍ يُمْسِرُونَ لَهُمْ  
مِنْ دُونِ اللَّهِ ۗ وَمَنْ يُضِلِلِ اللَّهُ فَمَا لَهُ مِنْ  
سَبِيلٍ ﴿٤٨﴾

اسْتَجِيبُوا لِرَبِّكُمْ ۖ مِنْ قَبْلِ أَنْ يَأْتِيَ يَوْمَ  
لَا مَرَدَّ لَهُ مِنَ اللَّهِ ۗ مَا لَكُمْ مِنْ مَلْجَأٍ  
يَوْمَئِذٍ وَمَا لَكُمْ مِنْ نَكِيرٍ ﴿٤٩﴾

فَإِنْ أَعْرَضُوا فَمَا أَرْسَلْنَا عَلَيْهِمْ  
حَفِيفًا ۗ إِنْ عَلَيْكَ إِلَّا الْبَلَاغُ ۗ وَإِنَّا إِذَا  
أَذَقْنَا الْإِنْسَانَ مِنَّا رَحْمَةً فَرَحَّ بِهَا ۗ وَإِن  
تُصِبْهُمْ سَيْئَةٌ بِمَا قَدَّمَتْ أَيْدِيَهُمْ فِإِنَّ  
الْإِنْسَانَ كَفُورٌ ﴿٥٠﴾

لِلَّهِ مُلْكُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ ۗ يَخْلُقُ مَا  
يَشَاءُ ۗ يَهَبُ لِمَنْ يَشَاءُ إِنَّا لَهُ نَهَبٌ لِمَنْ  
يَشَاءُ الدُّكُورَ ﴿٥١﴾

51. Ose i bashkon, djem e vajza, dhe kë të dojë e bën shterp. Sigurisht, Ai është i Gjithëdijshëm, i Plotfuqishëm.

أَوْ يَرْوِجُهُمْ ذُكْرَانًا وَنِسَاءً وَيَجْعَلُ مَنْ  
يَشَاءُ عَقِيمًا ۗ إِنَّهُ عَلِيمٌ قَدِيرٌ ﴿٥١﴾

52. Nuk është e mundur për një njeri që Allahu t'i flasë atij, përveçse me anë të shpalljes ose mbrapa një perdeje ose atij t'i dërgohet (prej Allahut) një i dërguar (pra, engjell), i cili i shpall atij me urdhrin e Tij për çfarë të dojë Ai. Sigurisht, Ai është shumë i Lartë, shumë i Urtë.<sup>14</sup>

وَمَا كَانَ لِبَشَرٍ أَنْ يُكَلِّمَهُ اللَّهُ إِلَّا وَحْيًا  
أَوْ مِنْ وَرَائِي حِجَابٍ أَوْ يُرْسِلَ رَسُولًا  
فَيُوحِي بآذَانِهِ مَا يَشَاءُ ۗ إِنَّهُ عَلِيمٌ  
حَكِيمٌ ﴿٥٢﴾

14. Komunikimi me Zotin ka tri lloje: *Vahji a ilhami* (shpallja), ëndrra dhe *keshfi* (vizioni). *Vahji* është ai që zbret pa ndonjë medium në zemrën e pastër të Profetit. Ky komunikim është më i qarti dhe më dritëploti. Lloji i dytë i komunikimit me Zotin është ëndrra dhe ajo vjen me ngjyra dhe kompleksitet. Ëndrra ka nënkuptime dhe figurshmëri. Siç i Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> një herë pa dy byzylykë në të dyja duart e tij të bekuara, ose një herë tjetër pa që duart më të gjata ishin të njëjës prej bashkëshorteve të tij, ose pa lopën etj., dhe i interpretoi. Pra, ky lloj komunikimi në përgjithësi kërkon interpretim. Lloji i tretë i komunikimit me Zotin është *keshfi* (vizioni) dhe ai bëhet në formë shëmbëlimesh, qoftë në pamjen e Xhibrailit<sup>as</sup> ose të ndonjë engjëlli tjetër ose të diçkaje tjetër.

Ky ajet praqet praktikën e përhershme të Zotit, pa e kushtëzuar me të kaluarën. Por komunikimi i gjatë dhe i plotë siç është shpallja, është i kushtëzuar me ndjekjen e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>. Pra, komunikimi me Zotin në të gjitha format e lartpërmendura kurrë nuk ndërpritet për njerëzit që janë shërbëtorë të Pejgamberit<sup>savs</sup> dhe të Islamit, kurse komunikimi që mund të sillte një Sheriat të ri apo një profetëri të pavarur është i ndërprerë përgjithmonë.

Hadithet tregojnë komunikimin Hyjnor dhe mrekullitë jo vetëm të Profetit<sup>savs</sup>, por edhe të sahabëve të tij. Falë komunikimit me Zotin, *Hazret Omeri*<sup>ra</sup> u njoftua se si mund të shmangte rrezikun Saria me gjithë ushtrinë e tij, dhe më pas zëri i *Hazret Omerit* – O Sarije, ngjitu malit! Malit! (Ja Sarije, el-xhebel! El-xhebel!), fjalë të cilat ai i shqiptoi në Medinë, përmes një fuqie të padukshme u dëgjuan nga Saria që gjendej shumë larg nga Medina. (Muhammed ibn Xherir et-Taberi, “Tarikh”, vëllimi II, shtëpia botuese: “El-Kutub el-’ilmijje”, Bejrut 2012, fq. 553-554.) Pra, Zoti i njoftoi ata përmes *ilhamit* (shpalljes) së Tij.

Por mjerisht një pjesë e muslimanëve të sotëm e mohojnë këtë bekim të Zotit. Çudi, kërkimi në natyrën e njeriut nuk u sos, sepse njeriu edhe sot ka të njëjtën etje për të kërkuar dhe njohur Zotin, por e kanë sosur komunikimin me Zotin duke i vënë kapak Burimit të Pashtershëm të njohjes së Zotit! Keqardhje për muslimanët e tillë, të cilëve iu mor buka në gjendje urie dhe iu mor uji edhe pse janë të etur! Por kjo nuk është e vërtetë. Kurani ka treguar shumë herë që në *umetet* e mëparshme njerëzit e thjeshtë e qofshin edhe gratë, kanë komunikuar me Zotin përmes shpalljes, andaj, nuk ishte e mundur që muslimanët e sinqertë, duke qenë ndjekës të *umetit* më të mirë dhe Profetit më të mirë, të privoheshin nga ky bekim. Lexoni edhe 41:31-32.

53. Po kështu Ne të shpallëm ty Shpirtin (pra, Fjalën) me urdhrin Tonë.<sup>15</sup> Ti nuk dije se ç'është Libri dhe ç'është besimi, por Ne e bëmë atë dritë me të cilën udhëzojmë kë të duam nga robërit Tanë; dhe pa dyshim, ti prin drejt rrugës së drejtë;

54. drejt rrugës së Allahut, të cilit i takon gjithçka që është në qiej dhe gjithçka që është në tokë. Dëgjoni! Tek Allahu kthehen çështjet.

وَكَذَلِكَ أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ رُوحًا مِّنْ أَمْرِنَا  
مَا كُنْتَ تَدْرِي مَا الْكِتَابُ وَلَا الْإِيمَانُ  
وَلَكِن جَعَلْنَاهُ نُورًا نَّهْدِي بِهِ مَن نَّشَاءُ  
مِّنْ عِبَادِنَا وَإِنَّكَ لَتَهْدِي إِلَى صِرَاطٍ  
مُّسْتَقِيمٍ ﴿٥٦﴾

صِرَاطِ اللَّهِ الَّذِي لَهُ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا  
فِي الْأَرْضِ ۗ أَلَا إِلَى اللَّهِ تَصِيرُ الْأُمُورُ ﴿٥٧﴾

15. Kurani këtu është quajtur Shpirt (*Ruh*), sepse nëpërmjet tij një popull që shpirtërisht ishte i vdekur, fitoi një jetë të re.

## Surja 43 – Ez-Zukhruf

Surja Ez-Zukhruf është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka nëntëdhjetë ajete.

Që në fillim të kësaj sureje përsëritet fjala “nënë” (*um-mu*), duke na kujtuar suren paraardhëse ku u përmend “ama e vendbanimeve” (*um-mul-kura*), ndërsa këtu kjo fjalë i referohet sures El-Fatiha, e cila gëzon pozitën për të qenë “nëna” e këtij Libri madhështor. Kjo do të thotë se thelbi i të gjitha temave është paraqitur në suren El-Fatiha, si barku i nënës ku njeriu merr të gjitha aftësitë themelore për të jetuar pasi të lindë.

Pas kësaj, në një ajet tjetër në vijim, Zoti i Madhërishëm thotë: Ju që udhëtoni, qoftë në tokë, qoftë në det, është pikërisht Allahu Ai që ju nënshtroi kafshët si mjete të transportit tokësor si dhe anijet në det, por mundet që një pjesë prej jush të mos arrijnë destinacionin e tyre për të cilin ishin nisur, duke pësuar ndonjë aksident gjatë rrugës, megjithatë, duhet të dini se destinacioni përfundimtar është tek Allahu, ku ju të gjithë do të paraqiteni.

Ndonëse ajetet e para të kësaj sureje përmendin ithtarët e Librit, ajetet që vijnë më pas, flasin për idhujtarët. Më pas, përmenden Profetët, të cilët kryesisht u ishin dërguar popujve idhujtarë, gjithashtu, përmenden edhe pasojat me të cilat këta popuj u përballën pas mohimit.

Në suren paraardhëse ishte folur për bashkimin e njerëzimit nën një dorë të vetme. Kjo sure na tregon se bashkimin e njerëzve lakmitarë, Zoti mund ta bënte vetëm me një metodë: t’ua mbushte shtëpitë me flori, argjend dhe begati të tjera. Por kjo do të ishte diçka krejt tokësore dhe materiale, dhe si e tillë, krejt e pakuptimtë. Pas argëtimit të shkurtër me luksin e kësaj bote, ata nuk do të kenë asnjë pjesë në botën vijuese, e cila është e rezervuar vetëm për ata që kanë drujtje ndaj Zotit.

Kjo sure përmend edhe një arsye tjetër se pse njerëzit nuk arrijnë të bashkohen në rrugën e udhëzimit. Thotë se ka nga ata që shokët e tyre janë të pafe, dhe nën ndikimin e tyre edhe ata ndjekin rrugën e mosbesimit. Por Ditën e Kiametit, thotë një ajet i kësaj sureje, secili prej atyre që pati ndikim negativ nga shoku i tij, do t’i drejtohet shokut me një zhgënjim të madh dhe do t’i thotë: Ah sikur mes meje e teje të kishim largësinë e Lindjes e të Perëndimit, unë nuk do të përfundoja në këtë disfatë sot!

Kjo sure ka një ajet të rëndësishëm që shpjegon edhe zbritjen e Hazret Mesihut<sup>as</sup>. Ajeti në fjalë thotë se Hazret Mesihu ishte thjesht një shembull dhe Profeti Muhammed kur ua përmendte idhujtarëve shembullin e tij, ata i thoshin: “Po të kishe dashur të pranoje zot tjetër përveç Allahut, pse na solle dikë nga një popull tjetër? Më mirë t’i mbajmë këta zota që kemi!” Këta idhujtarë nuk e kuptonin se Mesihu nuk ishte Zoti, por ishte një rob i bekuar i Zotit, dhe si i tillë, ishte një shembull për ta, për të marrë mësim të vyera prej tij. Pas kësaj, jepet edhe profecia se një shembull i tillë do të jetë

edhe në të ardhmen, dhe Mesihu sërish do të zbresë, i cili do të jetë një shenjë për të treguar se Ora e ndryshimit të madh është afruar.

Kjo sure tregon një pozitë shumë të madhe të Profetit Muhammed<sup>savs</sup> duke thënë se ai ishte adhuruesi më i madh i Allahut të Madhërishëm. Nëse Allahu me të vërtetë do të kishte ndonjë bir, Profeti<sup>savs</sup> kurrsesi nuk do të ngurronte ta adhuronte edhe atë. Andaj, mosadhurimi i Profetit<sup>savs</sup> ndaj ndonjë biri që ia kanë sajuar Allahut tregon se Profeti<sup>savs</sup> kishte besimin e plotë që Allahu është Një dhe i Vetëm.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. *Ha.Mim.* (I Lavdishëm, i Nde-ruar.)

هَـ ٓ حَ ٓ مِ ٓ ①

3. Beto hem për Librin e qartë!

وَالْكِتَابِ الْمُبِينِ ①

4. Pa dyshim, Ne e bëmë atë një Kuran elokuent, që ju të logjikoni.

إِنَّا جَعَلْنَاهُ قُرْآنًا عَرَبِيًّا لَعَلَّكُمْ تَعْقِلُونَ ①

5. Dhe, pa dyshim, ky (Kuran) gjendet në nënën e Librit (dhe) te Ne është i lartësuar, urtiplotë.

وَإِنَّهُ فِي أُمِّ الْكِتَابِ لَدَيْنَا لَعَلِّي حَكِيمٌ ①

6. A të tërhiqemi nga këshilla për ju vetëm sepse jeni një popull që tejkaloni kufijtë?!

أَفَضْرَبُ عَنْكُمْ الذِّكْرَ صَفْحًا أَنْ كُنْتُمْ قَوْمًا مُّسْرِفِينَ ①

7. Sa shumë profetë kemi dërguar edhe tek të parët!

وَكَمْ أَرْسَلْنَا مِنْ نَبِيِّ فِي الْأَوَّلِينَ ①

8. Çdoherë që u vinte ndonjë profet, ata e përqeshnin.

وَمَا يَأْتِيهِمْ مِنْ نَبِيِّ إِلَّا كَانُوا بِهِ يَسْتَهْزِئُونَ ①

9. Pra, kemi shkatërruar edhe ata që ishin më të fortë se këta. Ka kaluar shembulli i të parëve.

فَأَهْلَكْنَا أَشَدَّ مِنْهُمْ بَطْشًا وَ مَضَى مَثَلُ الْأَوَّلِينَ ①

10. Nëse i pyet: “Kush i krijoi qiejt dhe tokën?”, ata patjetër do të thonë: “I krijoi Mbizotëruesi, i Gjithëdijshmi”.

وَلَيْن سَأَلْتَهُمْ مَنْ خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ لَيَقُولُنَّ خَلَقَهُنَّ الْعَزِيزُ الْعَلِيمُ ①

11. (Pra), Ai që bëri për ju tokën shtrat, në të cilën bëri edhe rrugë për ju, që të udhëzoheni.

12. Dhe Ai që prej qiellit zbriti ujin në masë, më pas, përmes tij, Ne ringjallëm një tokë të vdekur. Kështu do të nxirreni ju.

13. Dhe Ai që krijoi çifte të çdolloji dhe për ju bëri anijet dhe bagëtitë me të cilat udhëtoni.

14. Që ju të rrini rehat mbi shpinën e tij (pra, të mjetit të udhëtimit). Më pas, kur ta zotëroni mirë atë, ta kujtoni bekimin e Zotit tuaj dhe të thoni: “I Shenjtë është Ai që nënshtroi këtë (mjet) për ne, se ne vetë nuk mund ta zotëronim dot;

15. dhe, te Zoti ynë ne do të kthehemi!”

16. Ata bënë disa nga robërit e Tij si pjesëtarë (në sundimin) e Tij. Njëmend, njeriu është mosmirënjohës i hapur!

17. A paska zgjedhur Ai vajzat nga ato që krijoi, ndërsa ju ju nderoi me djem?!

18. Por kur ndonjërit prej tyre i jepet lajmi i mirë për atë (pra, për vajzë) me të cilën ai e ka përshkruar (Zotin e) Gjithëmëshirshëm, atij i nxihet fytyra dhe brengoset.

الَّذِي جَعَلَ لَكُمُ الْأَرْضَ مَهْدًا وَ جَعَلَ  
لَكُمْ فِيهَا سُبُلًا لَعَلَّكُمْ تَهْتَدُونَ ﴿١١﴾

وَالَّذِي نَزَّلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً بِقَدَرٍ  
فَأَنْشَرْنَا بِهِ بَلْدَةً مَيْتًا كَذَلِكَ تُخْرَجُونَ ﴿١٢﴾

وَالَّذِي خَلَقَ الْأَزْوَاجَ كُلَّهَا وَ جَعَلَ لَكُمْ  
مِنَ الْفُلْكِ وَالْأَنْعَامِ مَا تَرْكَبُونَ ﴿١٣﴾

لِتَسْتَوُوا عَلَى ظُهُورِهِ ثُمَّ تَذْكُرُوا نِعْمَةَ  
رَبِّكُمْ إِذَا اسْتَوَيْتُمْ عَلَيْهِ وَتَقُولُوا سُبْحَانَ  
الَّذِي سَخَّرْنَا هَذَا وَمَا كُنَّا لَهُ  
مُقْرِنِينَ ﴿١٤﴾

وَإِنَّا إِلَى رَبِّنَا لَمُنْقَلِبُونَ ﴿١٥﴾

وَ جَعَلُوا لَهُ مِنْ عِبَادِهِ جُزْءًا إِنْ  
كُنَّ الْإِنْسَانَ لَكُفُورًا مُّيِّنِينَ ﴿١٦﴾

أَمْ اتَّخَذَ إِمَّا يَخْلُقُ بِنْتٍ وَ أَصْفَكُمْ  
بِالْبَنِينَ ﴿١٧﴾

وَإِذَا بُشِّرَ أَحَدُهُمْ بِمَا صَرَبَ لِلرَّحْمَنِ  
مَثَلًا ظَلَّ وَجْهَهُ مُسْوَدًّا وَهُوَ كَظِيمٌ ﴿١٨﴾

19. A (bëni pjesëtare të Zotit) atë që rritet në flori dhe që nuk (flet) qartë në grindje?!

أَوْ مَنْ يُنشِئُوا فِي الْحَلِيَّةِ وَهُوَ فِي الْخِصَامِ  
عَيْرٌ مُّيِّنٌ ﴿١٩﴾

20. Ata i bënë femra engjëjt, të cilët në të vërtetë janë robër të të Gjithëmëshirshmit. A ishin dëshmitarë gjatë krijimit të tyre?! Ne do ta shkruajmë dëshminë e tyre dhe ata do të pyeten.

وَجَعَلُوا الْمَلَائِكَةَ الَّذِينَ هُمْ عَبْدُ الرَّحْمَنِ  
إِنَّا نَاشِدُوا أَشْهَادًا وَخَلَقَهُمْ سَكَّابٌ شَهِادَتُهُمْ  
وَيُسْأَلُونَ ﴿٢٠﴾

21. Madje thonë: “Po të donte i Gjithëmëshirshmi, ne nuk do t’i adhuronim ata.” Nuk kanë kurrfarë dije për këtë. Ata vetëm hamendësojnë.

وَقَالُوا لَوْ شَاءَ الرَّحْمَنُ مَا عَبَدْنَاهُمْ ۗ مَا  
لَهُمْ بِذَلِكَ مِنْ عِلْمٍ إِنْ هُمْ إِلَّا  
يَخْرُصُونَ ﴿٢١﴾

22. A u kemi dhënë ndonjë Libër përpara këtij (Kurani), dhe ata atij po i përmbahen?!

أَمْ أَنْتُمْ لَهُمْ كِتَابًا مِنْ قَبْلِهِ فَهُمْ بِهِ  
مُسْتَمْسِكُونَ ﴿٢٢﴾

23. Jo, përkundrazi. Ata thonë: “Gjetëm baballarët tanë mbi një fe, dhe ne në gjurmët e tyre kërkojmë udhën.”

بَلْ قَالُوا إِنَّا وَجَدْنَا آبَاءَنَا عَلَىٰ أُمَّةٍ وَإِنَّا  
عَلَىٰ آثَرِهِمْ مُّهْتَدُونَ ﴿٢٣﴾

24. Po kështu, sa herë që kemi dërguar një alarmues në ndonjë vendbanim, pasanikët e tij thanë: “Gjetëm baballarët tanë mbi një fe, dhe ne gjurmët e tyre po i ndjekim.”

وَكَذَلِكَ مَا أَرْسَلْنَا مِنْ قَبْلِكَ فِي قَرْيَةٍ  
مِّنْ تَذْوِيرٍ إِلَّا قَالَ مُتْرَفُوهَا إِنَّا وَجَدْنَا  
آبَاءَنَا عَلَىٰ أُمَّةٍ وَإِنَّا عَلَىٰ آثَرِهِمْ  
مُقْتَدُونَ ﴿٢٤﴾

25. (Alarmuesi i tyre) tha: “Edhe sikur unë t’ju sjell diçka më të udhës sesa ajo në të cilën keni gjetur baballarët tuaj?!” Ata thanë: “Ne i mohojmë ato që keni sjellë ju!”

قُلْ أَوَلَوْ جِئْتُكُمْ بِأَهْدَىٰ مِمَّا وَجَدْتُمْ  
عَلَيْهِ آبَاءَكُمْ ۗ قَالُوا إِنَّا بِمَا أُرْسِلْتُمْ بِهِ  
كَفِرُونَ ﴿٢٥﴾

26. Atëherë Ne u hakmorëm me ta, dhe shih se si ishte fundi i mohuesve!

فَأَنْتَقَمْنَا مِنْهُمْ فَأَنْظُرُ كَيْفَ كَانَ  
دِيَارِ عَاقِبَةُ الْمَكْدِبِينَ ﴿٢٦﴾



27. Dhe (kujtoni) kur Ibrahim i tha babait dhe popullit të tij: “Unë përnjëmend jam i distancuar nga ato që adhuroni ju;

وَإِذْ قَالَ إِبْرَاهِيمُ لِأَبِيهِ وَقَوْمِهِ إِنَّنِي بَرَاءٌ مِّمَّا تَعْبُدُونَ ﴿٢٧﴾

28. por jo nga Ai që më krijoi, sepse pikërisht Ai do të më udhëzojë.”

إِلَّا الَّذِي فَطَرَنِي فَإِنَّهُ سَيَهْدِينِ ﴿٢٨﴾

29. Dhe ai e bëri këtë një fjalë të përhershme te pasardhësit e tij, që ata të kthehen.

وَجَعَلَهَا كَلِمَةً بَاقِيَةً فِي عَقِبِهِ لَعَلَّهُمْ يُرْجَعُونَ ﴿٢٩﴾

30. E vërteta është që Unë i begatova edhe ata, edhe baballarët e tyre, derisa u erdhën e vërteta dhe një i Dërguar i qartë.

بَلْ مَتَّعْتُ هَؤُلَاءِ وَأَبَاءَهُمْ حَتَّىٰ جَاءَهُمُ الْحَقُّ وَرَسُولٌ مُّبِينٌ ﴿٣٠﴾

31. E kur u erdhi e vërteta, thanë: “Kjo është magji dhe, sigurisht, ne e mohojmë këtë!”

وَلَمَّا جَاءَهُمُ الْحَقُّ قَالُوا هَذَا سِحْرٌ وَإِنَّا بِهِ كَافِرُونَ ﴿٣١﴾

32. Dhe thanë: “Ky Kuran pse nuk zbriti mbi ndonjë burrë të madh nga njëri prej dy qyteteve?”<sup>1</sup>

وَقَالُوا لَوْلَا نَزَّلَ هَذَا الْقُرْآنُ عَلَىٰ رَجُلٍ مِّنَ الْقُرَيْتَيْنِ عَظِيمٍ ﴿٣٢﴾

33. Pse, a janë ata që shpërndajnë mëshirën e Zotit tënd?! Jemi Ne që kemi shpërndarë mjetet e jetesës midis tyre në jetën e kësaj bote, dhe kemi ngritur në pozitë disa prej tyre mbi disa të tjerë, që disa të marrin për shërbim disa të tjerë. Dhe mëshira e Zotit tënd është më e mirë se ajo që ata grumbullojnë.<sup>2</sup>

أَهُمْ يَقْسِمُونَ رَحْمَتَ رَبِّكَ ۗ نَحْنُ قَسَمْنَا بَيْنَهُمْ مَعِيشَتَهُمْ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَرَفَعْنَا بَعْضَهُمْ فَوْقَ بَعْضٍ دَرَجَاتٍ لِّيَتَّخِذَ بَعْضُهُم بَعْضًا سَخِرِيًّا ۗ وَرَحْمَتُ رَبِّكَ خَيْرٌ مِّمَّا يَجْمَعُونَ ﴿٣٣﴾

1. Me “dy qytete” në përgjithësi kuptohet se ishin Meka dhe Taifi, pasi ato ishin dy qendra të rëndësishme të jetës shoqërore dhe politike arabe në kohën e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>.

2. Ajeti i qorton ashpër jobsimtarët duke thënë – Që kur janë bërë ata shpërndarës të mëshirës së Zotit?! Pra, përveç Zotit, askujt nuk i takon të përcaktojë se kë do të zgjedhë Zoti për fenë e Tij.

34. Dhe po të mos ishte gjasa që (të gjithë) njerëzit të bëheshin të njëllojtë, Ne për ata që mohojnë të Gjithëmëshirshmin, patjetër do t'u bënim prej argjendi çatitë e shtëpive të tyre dhe po kështu edhe shkallët mbi të cilat ata ngjiten;

وَلَوْ لَا أَنْ يَكُونَ النَّاسُ أُمَّةً وَاحِدَةً  
لَجَعَلْنَا لِمَنْ يَكْفُرُ بِالرَّحْمَنِ لِبُيُوتِهِمْ  
سُقْفًا مِّنْ فَضَّةٍ وَ مَعَارِجَ عَلَيْهَا  
يُظْهِرُونَ ﴿٣٤﴾

35. (do t'u bënim prej argjendi) edhe dyert e shtëpive, po kështu edhe fronet ku ata mbështeten;

وَلِبُيُوتِهِمْ أَبْوَابًا وَ سُرُرًا عَلَيْهَا  
يَتَّكِفُونَ ﴿٣٥﴾

36. dhe do t'ua stolisnim jetën. Por e gjithë kjo do të ishte vetëm përfitim i shkurtër i jetës së kësaj bote. Kurse *ahireti* te Zoti yt është për të druajturit (ndaj Tij).

وَرُحْرُقًا ۖ وَإِنْ كُلُّ ذَلِكَ لَمَّا مَتَاعَ الْحَيَاةِ  
الدُّنْيَا ۗ وَالْآخِرَةُ عِنْدَ رَبِّكَ لِلْمُتَّقِينَ ﴿٣٦﴾

37. Ai që shpërfill kujtimin e të Gjithëmëshirshmit, Ne atij i ngjisim një djall, dhe pikërisht ai bëhet shok i tij.

وَمَنْ يَعْشُ عَنْ ذِكْرِ الرَّحْمَنِ نُقَيِّضْ لَهُ  
شَيْطَانًا فَهُوَ لَهُ قَرِينٌ ﴿٣٧﴾

38. Dhe pikërisht këta (djaj) i largojnë (njerëzit e tillë) nga rruga, ata ndërkohë mendojnë se janë të udhëzuar.

وَإِنَّهُمْ لَيَصُدُّونَهُمْ عَنِ السَّبِيلِ وَيَحْسَبُونَ  
أَنَّهُم مُّهْتَدُونَ ﴿٣٨﴾

39. Por kur mbërrin te Ne, (i) thotë (shokut të vet): “Ah sikur mes meje e teje të kishim largësinë e Lindjes e të Perëndimit!”

حَتَّىٰ إِذَا جَاءَنَا قَالَ يَا لَيْتَ بَيْنِي وَبَيْنَكَ  
بُعْدَ الْمَشْرِقَيْنِ فَبِئْسَ الْقَرِينُ ﴿٣٩﴾

40. Por pasi që keni bërë keq, sot kjo nuk do t'ju vlejë fare (dhe) bashkërisht jeni pjesëtarë në dënim.

وَلَنْ يَنْفَعَكُمْ الْيَوْمَ إِذْ ظَلَمْتُمْ أَنْكُمُ فِي  
الْعَذَابِ مُشْتَرِكُونَ ﴿٤٠﴾

41. A mund t'i bësh të shurdhrit të dëgjojnë, ose t'ua tregosh udhën të verbërve ose atij që është në devijim të qartë?!

أَفَأَنْتَ تَسْمَعُ الصَّمَّ أَوْ تَهْدِي الْعُمْىَ وَمَنْ  
كَانَ فِي ضَلَالٍ مُّبِينٍ ﴿٤١﴾

42. Andaj, edhe sikur të të largojmë ty, Ne patjetër që kemi për t'u hakmarrë me ta.

فَأَمَّا نَذْهَبَنَّ بِكَ فَإِنَّا مِنْهُمْ مُنْتَقِمُونَ ﴿٤٢﴾

43. Ose do të ta tregojmë atë që u kemi premtuar. Pra, Ne zotërojmë pushtetin e plotë mbi ta.

أَوْ نُرِيَنَّكَ الَّذِي وَعَدْنَاهُمْ فَإِنَّا عَلَيْهِمْ مُقْتَدِرُونَ ﴿٤٣﴾

44. Prandaj, përmbahu asaj që të shpallet ty. Sigurisht, ti je në rrugë të drejtë.

فَأَسْتَمْسِكْ بِالَّذِي أُوحِيَ إِلَيْكَ ۚ إِنَّكَ عَلَىٰ صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ ﴿٤٤﴾

45. Dhe, sigurisht, ky është një kujtim për ty dhe për popullin tënd, dhe ju do të pyeteni.

وَإِنَّهُ لَذِكْرٌ لَّكَ وَلِقَوْمِكَ ۚ وَسَوْفَ تُسْأَلُونَ ﴿٤٥﴾

46. Pyeti të Dërguarit që kemi dërguar para teje: “Përveç të Gjithëmëshirshmit, a kemi caktuar zota të tjerë për t'u adhuruar?”

وَسَأَلَ مَنْ أَرْسَلْنَا مِنْ قَبْلِكَ مِنْ رُسُلِنَا أَجَعَلْنَا مِنْ دُونِ الرَّحْمَنِ إِلَهًا يُعْبَدُونَ ۗ ﴿٤٦﴾

47. Pa dyshim, Ne dërguam Musain me shenjat Tona te Faraoni dhe paria e tij. Ai tha: “Unë jam i Dërguari i Zotit të botëve”.

وَلَقَدْ أَرْسَلْنَا مُوسَىٰ بِآيَاتِنَا إِلَىٰ فِرْعَوْنَ وَمَلَئِهِ فَقَالَ إِنِّي رَسُولُ رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿٤٧﴾

48. Sa u erdhi ai me shenjat Tona, ata zunë të përqeshnin.

فَلَمَّا جَاءَهُمْ بِآيَاتِنَا إِذَاهُمْ مِنْهَا يَصْحَكُونَ ﴿٤٨﴾

49. Dhe çdoherë Ne u tregonim një shenjë më të madhe se e mëparshmjja. I shtrënguam përmes ndëshkimit, që të tërhiqeshin.

وَمَا نُرِيهِمْ مِنْ آيَةٍ إِلَّا هِيَ أَكْبَرُ مِنْ أُخْتِهَا ۗ وَأَخَذْنَاهُمْ بِالْعَذَابِ لَعَلَّهُمْ يَرْجِعُونَ ﴿٤٩﴾

50. Por ata thanë: “O magjistar! Lute Zotin tënd për atë që Ai të ka premtuar ty; pa dyshim, atëherë do ta ndjekim udhëzimin.”

وَقَالُوا يَا أَيُّهُ السَّحْرُ ادْعُ لَنَا رَبَّكَ بِمَا عَهِدَ عِنْدَكَ ۚ إِنَّا لَمُهْتَدُونَ ﴿٥٠﴾

51. Dhe sapo Ne ua larguam ndëshkimin, ata dolën të pabesë.

فَلَمَّا كَشَفْنَا عَنْهُمْ الْعَذَابَ إِذَا هُمْ  
يَسْتَكْبِرُونَ ﴿٥١﴾

52. Faraoni bëri njoftimin mes popullit të tij. Tha: “O populli im! A nuk më takon mua mbretëria e Egjiptit dhe këta lumenj që rrjedhin nën pushtetin tim?! A nuk shihni?!”

وَنَادَى فِرْعَوْنُ فِي قَوْمِهِ قَالَ يَا قَوْمِ أَلَيْسَ لِي مُلْكُ مِصْرَ وَهَذِهِ الْأَنْهَارُ  
تَجْرِي مِن تَحْتِي أَفَلَا تُبْصِرُونَ ﴿٥٢﴾

53. Apo nuk jam më i mirë se ky i përbuzur dhe (që) nuk di as të shprehet?!

أَمْ أَنَا خَيْرٌ مِّنْ هَذَا الَّذِي هُوَ مَهِينٌ ﴿٥٣﴾ وَلَا  
يَكَادُ يُبِينُ ﴿٥٤﴾

54. Pse nuk i janë zbritur atij byzylykë prej ari dhe pse nuk erdhën me të engjëjt tufa-tufa?!”

فَلَوْلَا أُنزِلَ عَلَيْهِ آسُورَةٌ مِّنْ ذَهَبٍ أَوْ  
جَاءَ مَعَهُ الْمَلَائِكَةُ مُقَاتِلِينَ ﴿٥٤﴾

55. Ai nuk e vlerësoi popullin e tij, dhe ata i bindeshin. Pa dyshim, ata ishin popull i pabindur.

فَأَسْتَخَفَّ قَوْمَهُ فَاطَاعُوهُ ۗ إِنَّهُمْ كَانُوا  
قَوْمًا فَاسِقِينَ ﴿٥٥﴾

56. Kur Na zemëruan, Ne u hakmorëm me ta dhe i fundosëm të gjithë ata.

فَلَمَّا أَسْفُونَا أَنْتَقَمْنَا مِنْهُمْ فَأَغْرَقْنَاهُمْ  
أَجْمَعِينَ ﴿٥٦﴾

57. I bëmë të shkuar dhe shembull për të mëvonshmit.

فَجَعَلْنَاهُمْ سَلَفًا وَمَثَلًا لِلْآخِرِينَ ﴿٥٧﴾

58. Dhe kur Biri i Merjemes jepet si shembull, populli yt menjëherë fillon të bëjë zhurmë.

وَلَمَّا ضُرِبَ ابْنُ مَرْيَمَ مَثَلًا إِذَا قَوْمُكَ  
مِنْهُ يُصِدِّدُونَ ﴿٥٨﴾

59. Ata thonë: “Më të mirët janë zotat tanë apo ai?” Nuk ta thonë këtë, por vetëm se për t’u grindur. Madje, ata janë një popull shumë grindavec.

وَقَالُوا ءِإِهْتَنَا خَيْرٌ أَمْ هُوَ ۗ مَا ضَرَبُوهُ  
لَكَ إِلَّا جَدَلًا ۗ بَلْ هُمْ قَوْمٌ خَصِمُونَ ﴿٥٩﴾

60. Ai ishte vetëm një rob, të cilin Ne e bekuam dhe e bëmë shembull për

إِنَّ هُوَ إِلَّا عَبْدٌ أَنْعَمْنَا عَلَيْهِ وَجَعَلْنَاهُ مَثَلًا

bijtë e Izraelit.

لَبَّيْ سِرَائِيلَ ۝

61. Sikur të donim, prej jush do të bënim engjëj që të shërbenin si mëkëmbës në tokë.<sup>3</sup>

وَلَوْ نَشَاءُ لَجَعَلْنَا مِنْكُمْ مَلَائِكَةً فِي الْأَرْضِ  
يَحْلُقُونَ ۝

62. Dhe, pa dyshim, ai është një shenjë për Orën, andaj, ju mos e dyshoni (Orën) dhe më ndiqni mua. Kjo është rruga e drejtë.

وَإِنَّهُ لَعَلَّمَ لِّلسَّاعَةِ فَلَا تَمْتَرُنَّ بِهَا  
وَاتَّبِعُونِ ۝ هَذَا صِرَاطٌ مُسْتَقِيمٌ ۝

63. Djalli nuk duhet t'ju ndalojë ju; ai pa dyshim është armiku juaj i hapur.

وَلَا يَصُدُّكُمْ الشَّيْطَانُ ۝ إِنَّهُ لَكُمْ عَدُوٌّ  
مُّبِينٌ ۝

64. Dhe kur Isai erdhi me shenjat e qarta, tha: “Unë kam ardhur te ju me urtësinë dhe që t’ju shpjegoj qartë disa nga ato në të cilat kundërshtoni njëri-tjetrin; andaj, kini druajtje ndaj Allahut dhe bindmuni mua!

وَلَمَّا جَاءَ عِيسَىٰ بِالْبَيِّنَاتِ قَالَ قَدْ جِئْتُكُمْ  
بِالْحِكْمَةِ وَلِأُبَيِّنَ لَكُمْ بَعْضَ الَّذِي  
تَخْتَلِفُونَ فِيهِ ۝ فَاتَّقُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا ۝

65. Pikërisht Allahu është Zoti im dhe Zoti juaj, andaj, atë adhurojeni; kjo është rrugë e drejtë.”

إِنَّ اللَّهَ هُوَ رَبِّي وَرَبُّكُمْ فَاعْبُدُوهُ ۝ هَذَا  
صِرَاطٌ مُسْتَقِيمٌ ۝

66. Atëherë grupet mes tyre kundërshtuan. U shkatërrofshin përmes ndëshkimit të një dite të dhimbshme, ata që bënë mizori!

فَاخْتَلَفَ الْأَحْرَابُ مِنْ بَيْنِهِمْ ۝ فَوَيْلٌ  
لِّلَّذِينَ ظَلَمُوا مِنْ عَذَابِ يَوْمِ إِلِيمٍ ۝

67. A po presin vetëm që Ora (e kiametit) t’u vijë befas dhe ata të mos kuptojnë gjë?!

هَلْ يَنْظُرُونَ إِلَّا السَّاعَةَ أَنْ تَأْتِيَهُمْ بَغْتَةً  
وَهُمْ لَا يَشْعُرُونَ ۝

3. Engjëjt nuk mund të shërbenin si model për njerëzit, prandaj Zoti gjithmonë ka caktuar njerëz si profetë që jo vetëm t’ua kumtonin qartë popujve të tyre mesazhin e Tij, por edhe t’ua paraqitnin shembullin e vet duke u bërë model për ta.

68. Atë ditë shokët e ngushtë do të bëhen armiq të njëri-tjetrit, por jo të druajturit (ndaj Zotit).

الْأَحْلَاءُ يَوْمَئِذٍ بَعْضُهُمْ لِبَعْضٍ عَدُوٌّ  
إِلَّا الْمُتَّقِينَ ﴿٦٨﴾

69. “O robërit e Mi! Sot nuk do të keni aspak frikë dhe as nuk do të brengoseni!”

لِعِبَادٍ لَا خَوْفَ عَلَيْكُمُ الْيَوْمَ وَلَا أَنْتُمْ  
تَحْزَنُونَ ﴿٦٩﴾

70. Janë këta që besuan ajetet Tona dhe u bënë të nënshtruar.<sup>4</sup>

الَّذِينَ آمَنُوا بِالْبَيِّنَاتِ وَكَانُوا مُسْلِمِينَ ﴿٧٠﴾

71. Hyni në xhenet ju dhe bashkëshortët tuaj (që) të lumturoheni!

أَدْخُلُوا الْجَنَّةَ أَنْتُمْ وَأَزْوَاجُكُمْ  
مُخْتَبِرُونَ ﴿٧١﴾

72. Atyre do t’u shërbehet vazhdimisht me tabaka dhe kupa prej ari; në të ata do të kenë gjithçka që u do shpirti dhe me të cilën u kënaqen sytë. Ju në të do të jetoni përgjithmonë.

يُطَافُ عَلَيْهِمْ بِصَفَافٍ مِّنْ ذَهَبٍ وَ  
أَكْوَابٍ<sup>٤</sup> وَفِيهَا مَا تَشْتَهِيهِ الْأَنْفُسُ وَتَلَذُّ  
الْأَعْيُنُ<sup>٤</sup> وَأَنْتُمْ فِيهَا خَالِدُونَ ﴿٧٢﴾

73. Ky pikërisht është xheneti që keni trashëguar për shkak të asaj që bënit.

وَتِلْكَ الْجَنَّةُ الَّتِي أُورِثْتُمُوهَا بِمَا  
كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ ﴿٧٣﴾

74. Në të do të keni fruta të shumta që do t’i hani.

لَكُمْ فِيهَا فَاكِهَةٌ كَثِيرَةٌ مِنْهَا تَأْكُلُونَ ﴿٧٤﴾

75. Pa dyshim, fajtorët do të jenë në ndëshkimin e xhehenemit për një kohë të gjatë.

إِنَّ الْمَجْرِمِينَ فِي عَذَابٍ جَهَنَّمَ  
خَالِدُونَ ﴿٧٥﴾

76. Nuk do t’u pakësohet (ndëshkimi) dhe ata në të do të mbeten të dëshpëruar.

لَا يُفَقَّرُ عَنْهُمْ وَهُمْ فِيهِ مُبْلِسُونَ ﴿٧٦﴾

4. U bënë muslimanë.

77. Nuk u kemi bërë keq Ne, përkundrazi, ata vetë ishin keqbërës.

وَمَا ظَلَمْنَاهُمْ وَلَكِنْ كَانُوا هُمُ الظَّالِمِينَ ﴿٧٧﴾

78. Do të thërrasin: “O Malik!<sup>5</sup> Le të na japë vdekjen Zoti yt!” Ai do t’u thotë: “Ju këtu keni për të qëndruar!”

وَنَادُوا لِمَلِكٍ يُفِضُ عَلَيْنَا رَبَّنَا قَالَ إِنَّكُمْ مُرْكُتُونَ ﴿٧٨﴾

79. Sigurisht, Ne ju sollëm të vërtetën, por shumica prej jush e urrenit të vërtetën.

لَقَدْ جِئْنَاكُمْ بِالْحَقِّ وَلَكِنْ أَكْثَرَكُمْ لِلْحَقِّ كُرْهُونَ ﴿٧٩﴾

80. A kanë vendosur të bëjnë diçka?! Atëherë, edhe Ne kemi vendosur.

أَمْ أَبْرَمُوا أَمْ إِنَّا فَأَنَّا مُبْرَمُونَ ﴿٨٠﴾

81. A mendojnë se Ne nuk dëgjojmë sekretin e tyre dhe këshillimin e tyre të fshehtë? Si jo?! Të dërguarit Tanë janë me ta (që) shkruajnë.

أَمْ يَحْسَبُونَ أَنَّا لَا نَسْمَعُ سِرَّهُمْ وَنَجْوَاهُمْ بَلَىٰ وَرُسُلْنَا لَدَيْهِمْ يَكْتُبُونَ ﴿٨١﴾

82. Thuaj: “Nëse i Gjithëmëshirshmi do të kishte bir, unë i pari do ta adhuroja atë!”

قُلْ إِنْ كَانَ لِلرَّحْمَنِ وَلَدٌ فَأَنَا أَوَّلُ الْعَادِينَ ﴿٨٢﴾

83. I Pastër është Zoti i qiejve dhe i tokës, Zoti i Arshit, nga ajo që ata përshkruajnë.

سُبْحَانَ رَبِّ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ رَبِّ الْعَرْشِ عَمَّا يَصِفُونَ ﴿٨٣﴾

84. Andaj, lëri të bëjnë kotësi e të luajnë, derisa ta shohin ditën e tyre që u është premtuar.

فَذَرَهُمْ يَخُوضُوا وَيَلْعَبُونَ حَتَّىٰ يُلَاقُوا يَوْمَهُمُ الَّذِي يُوعَدُونَ ﴿٨٤﴾

85. Pikërisht Ai është i Adhuruar në qiell dhe i Adhuruar në tokë dhe Ai është i Urti, i Gjithëdijshmi.

وَهُوَ الَّذِي فِي السَّمَاءِ إِلَهٌ وَفِي الْأَرْضِ إِلَهٌ وَهُوَ الْحَكِيمُ الْعَلِيمُ ﴿٨٥﴾

86. Vetëm Ai ka bekime të cilit i përket sundimi i qiejve, i tokës dhe i

وَتَبَارَكَ الَّذِي لَهُ مُلْكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا وَعِنْدَهُ عِلْمُ

5. Engjëll mbikëqyrës i xhehenemit.

gjithçkaje që është mes tyre. Tek Ai është dija e Orës. Dhe tek Ai do të ktheheni.

السَّاعَةِ وَإِلَيْهِ تُرْجَعُونَ ﴿٨٧﴾

87. Kurse ata të cilëve këta u lutën duke e lënë (Allahun), nuk zotërojnë ndërmjetësimin, përveç atyre që dëshmojnë të vërtetën dhe dinë.

وَلَا يَمْلِكُ الَّذِينَ يَدْعُونَ مِنْ دُونِهِ  
الشفاعة إلا من شهد بالحق وهم  
يعلمون ﴿٨٧﴾

88. Nëse i pyet që kush i krijoi ata, patjetër do të thonë: “Allahu!” Atëherë ku po largohen ata?!

وَلَيْنِ سَأَلْتَهُمْ مَنْ خَلَقَهُمْ لَيَقُولَنَّ اللَّهُ  
فَأَنَّى يُؤْفَكُونَ ﴿٨٨﴾

89. Dhe (kujtoni) fjalën e tij: “O Zoti im! Këta janë njerëz që nuk besojnë!”

وَقِيلِهِ يَا رَبِّ إِنَّ هَؤُلَاءِ قَوْمٌ لَا  
يُؤْمِنُونَ ﴿٨٩﴾

90. Andaj, toleroji dhe thuaju: “Paqe!” Së shpejti do të mësojnë.

فَاصْفَحْ عَنْهُمْ وَقُلْ سَلَامٌ فَسَوْفَ  
يَعْلَمُونَ ﴿٩٠﴾



## Surja 44 – Ed-Dukhan

Surja Ed-Dukhan është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka gjashtëdhjetë ajete.

Ajetet e para të kësaj sureje i referohen sures El-Kader, e cila është njëra prej sureje të shkurtra të Kuranit të Shenjtë. Me pak fjalë, Zoti i Madhërishëm në këto ajete pohon: Ne e zbritëm këtë Libër në një natë të bekuar, sepse nëpërmjet tij, nata do të kthehej në agim të mbarë të mëshirës, dhe gjithashtu, gjatë kësaj nate u vendos çdo çështje urtiplote.

Në fund të sures paraardhëse, Zoti i tha Profetit<sup>savs</sup>: Toleroji kundërshtarët dhe lëri të merren me kotësitë e tyre dhe të argëtohen, sepse koha është afër kur do të dallohet qartë e vërteta nga gënjeshtria. Kjo pikërisht thuhet edhe në fillim të kësaj sureje.

Njëra prej arsyeve kryesore të emrit të kësaj sureje, pra Ed-Dukhan (Tymi), është që mohuesit e Zotit gjithashtu janë në errësira, të cilat nuk u premtojnë asnjë agim të mëshirës, përkundrazi, do t'ua shtojnë ndëshkimin edhe më shumë në formën e një tymi. Këtu Tymi mund të nënkuptojë edhe tymin që shkaktohet nga luftërat atomike, në hijen e të cilave asgjë nuk është e mbrojtur, madje do të ketë shkatërrime nga më të ndryshmet. Shkencëtarët vazhdimisht ngrenë alarmin në këtë kohë që çdo jetë që do të vijë nën hijen e shpërthimit atomik, do të shuhet, madje do të asgjësohen edhe mikrobet e tokës. Zoti i Madhërishëm thotë, kur do të ndodhë kjo, atëherë ata do t'i kushtojnë rëndësi Zotit dhe do të thonë: O Allah! Largona këtë ndëshkim tejet të dhimbshëm! Këtu profecia gjithashtu tregon se një ndëshkim i tillë do të vijë gradualisht dhe me ndërprerje. Pra, pas shkatërrimeve nga një luftë botërore, do të ketë qetësi të përkohshme, pas së cilës, lufta tjetër botërore do të sjellë shkatërrime të reja edhe më të rënda.

Për Suren Ed-Dukhan, Allahu i Madhërishëm i tregoi Profetit Muhammed<sup>savs</sup> që kjo profeci do të përmbushej në kohën e Dexhallit.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. *Ha.Mim.* (I Lavdishëm, i Nde-ruar.)

هـ ح ①

3. Beto hem për Librin e qartë!

وَالكِتَابِ الْمُبِينِ ①

4. Ne e zbritëm atë në një natë të bekuar. Pa dyshim, Ne paralajmërojmë.

إِنَّا أَنْزَلْنَاهُ فِي لَيْلَةٍ مُبَارَكَةٍ إِنَّا كُنَّا مُنذِرِينَ ①

5. Në këtë (natë) caktohet çdo çështje urtiplote;

فِيهَا يُفْرَقُ كُلُّ أَمْرٍ حَكِيمٍ ①

6. si dekret nga ana Jonë. Pa dyshim, Ne dërgojmë (të Dërguarit);

أَمْراً مِّنْ عِنْدِنَا إِنَّا كُنَّا مُرْسِلِينَ ①

7. si mëshirë prej Zotit tënd; sigurisht, Ai është Gjithëdëgjuesi, i Gjithëdijshmi;

رَحْمَةً مِّنْ رَبِّكَ إِنَّهُ هُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ ①

8. (si mëshirë prej) Zotit të qiejve, të tokës dhe të asaj që gjendet mes tyre, nëse doni të besoni.

رَبِّ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا إِنَّ كُنْتُمْ مَوْقِنِينَ ①

9. Nuk ka të adhureshëm tjetër përveç Atij; Ai jep jetë dhe vdekje; Zoti juaj dhe Zoti i etërve tuaj të parë.

لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ يُحْيِي وَيُمِيتُ رَبُّكُمْ وَرَبُّ آبَائِكُمُ الْأُولِينَ ①

10. Por ata janë në (gjendje) dyshimi (dhe) po luajnë.

بَلْ هُمْ فِي شَكٍّ يَلْعَبُونَ ①

11. Andaj, prit ditën kur qielli do të sjellë një tym të qartë.

فَأَرْتَقِبْ يَوْمَ تَأْتِي السَّمَاءُ بِدُحَانٍ مُّبِينٍ ①

12. Që do të mbulojë njerëzit. Ky është një ndëshkim i dhimbshëm.<sup>1</sup>

يَغْشَى النَّاسَ هَذَا عَذَابٌ أَلِيمٌ ⑩

13. “O Zoti ynë! Largo prej nesh ndëshkimit! Ne sigurisht do të besojmë!”

رَبَّنَا اكْشِفْ عَنَّا الْعَذَابَ إِنَّا مُؤْمِنُونَ ⑪

14. Por tani ç'dobi do t'u sjellë këshilla, përderisa atyre u kishte ardhur një i Dërguar i qartë!

إِنِّي لَهُمُ الذِّكْرَى وَقَدْ جَاءَهُمْ رَسُولٌ مُّبِينٌ ⑫

15. Prapëseprapë ata e shpërfillën atë dhe thanë: “është i mësuar (prej dikujt, madje) i çmendur”.

ثُمَّ تَوَلَّوْا عَنْهُ وَقَالُوا مُعَلَّمٌ مَّجْنُونٌ ⑬

16. Sigurisht, Ne do ta largojmë ndëshkimit për pak kohë, (por) ju do të përsëritni (të njëjtën gjë).

إِنَّا كَاشِفُو الْعَذَابِ قَلِيلًا إِنَّكُمْ عَائِدُونَ ⑭

17. Ditën kur Ne do t'ju zëmë fuqishëm! Sigurisht, Ne do të hakmerremi.

يَوْمَ نَبْطِشُ الْبَطْشَةَ الْكُبْرَى ۗ إِنَّا مُنتَقِمُونَ ⑮

18. Ne kemi sprovuar para tyre edhe popullin e Faraonit, kur atyre u erdhi një i Dërguar i nderuar.

وَلَقَدْ قَاتْنَا قَبْلَهُمْ قَوْمَ فِرْعَوْنَ وَجَاءَهُمْ رَسُولٌ كَرِيمٌ ⑯

1. Siç u tha në parathënien e sures që Dukhani (Tymi) është një ndër dhjetë shenjat kryesore të kohës së Imam Mehdiut dhe të Mesihut të Premtuar, dhe thamë që kjo nënkupton tymin, që do të shkaktonin luftërat atomike. Përveç kësaj, edhe në aspektin shpirtëror sot bota është e mbërthyer në një tym. Mashtrimi dhe përdorimi i gabuar i teknologjisë janë përhapur si një tym dhe sa vjen e rëndohet. Çrregullimet e kësaj kohe janë krejt të ndryshme nga çrregullimet e kohërave të mëparshme. Në të kaluarën shpesh vetëm injoranca dhe analfabetizmi ishin ato që e shkatërronin njeriun, por kjo kohë e shkencës, të cilën e quajmë epokë drite, duhet quajtur edhe epokë tymi sepse në mënyrë të çuditshme ka dëmtuar besimin, sinqeritetin dhe pastërtinë e brendshme. Tymi i përhapur nga mendimet sofistike e ka mbuluar diellin e së vërtetës dhe arsyetimet e bazuara mbi filozofi të gabuara i kanë futur njerëzit në një mjegullnajë. Kështu që, çmohen idetë e gabuara, kurse vërtetësitë fisnike shihen me përçmim. Andaj, në këtë kohë kur është shfaqur tymi, Zoti caktoi të vinte edhe Imam Mehdiu për t'u dhënë qartësi atyre që donin të dilnin nga kjo mjegullnajë.

19. që (u tha:) “Mi dorëzoni robërit e Allahut; unë jam i Dërguar i qartë për ju!

أَنْ أَدُّوْا إِلَىٰ عِبَادِ اللَّهِ ۗ إِنِّي لَكُم رَسُوْلٌ  
أَمِيْنٌ ﴿١٩﴾

20. Dhe mos u rebeloni kundër Allahut; unë do t’ju sjell një argument të qartë.

وَ أَنْ لَا تَحْلُوْا عَلَىٰ اللَّهِ ۗ إِنِّي آتِيْكُم  
بِسُلْطٰنٍ مُّبِيْنٍ ﴿٢٠﴾

21. Dhe unë mbrohem me Zotin tim dhe Zotin tuaj që të mos më gurëzoni.

وَ إِنِّي عُدْتُ بِرَبِّي وَرَبِّكُمْ أَنْ تَرْجُمُوْنِ ﴿٢١﴾

22. Nëse nuk do të më besoni, më lini mënjanë.”

وَ إِنْ لَّمْ تُؤْمِنُوْا لِي فَاعْتَرِلُوْنِ ﴿٢٢﴾

23. Atëherë ai iu lut Zotit të tij: “Këta janë popull fajtor”.

فَدَعَا رَبَّهُ أَنْ هُوَ لَآءِ قَوْمٍ مُّجْرِمُوْنَ ﴿٢٣﴾

24. “Nisu me robërit e Mi gjatë natës. Sigurisht, do të ndiqeni.

فَآسِرِ بِعِبَادِي لَيْلًا إِنَّكُمْ مُّتَّبَعُوْنَ ﴿٢٤﴾

25. Lëre detin të qetë. Ata janë një ushtri që do të fundosen.”

وَ اتْرِكِ الْبَحْرَ رَهَوًّا ۗ إِنَّهُمْ جُنْدٌ  
مُّغْرَقُوْنَ ﴿٢٥﴾

26. Sa kopshte e burime ata kanë lënë pas!

كَمْ تَرَكُوْا مِنْ جَبْتٍ وَ عِيُوْنٍ ﴿٢٦﴾

27. Dhe ara e vende madhështore!

وَ زُرُوْعٍ وَ مَقَامٍ كَرِيْمٍ ﴿٢٧﴾

28. Dhe begati në të cilat ata kënaqeshin!

وَ نَعْمَةٍ كَانُوْا فِيْهَا فٰكِهِيْنَ ﴿٢٨﴾

29. Kështu ndodhi. Dhe këto ia trashëguam një populli tjetër.

كَذٰلِكَ ۗ وَ أَوْرَثْنٰهَا قَوْمًا آخَرِيْنَ ﴿٢٩﴾

30. Dhe nuk qau as qielli e as toka mbi ta, dhe atyre as nuk u është dhënë afat.

فَمَا بَكَتْ عَلَيْهِمُ السَّمَآءُ وَ الْآرْضُ وَ مَا  
كَانُوْا مُنْظَرِيْنَ ﴿٣٠﴾

31. Ne i shpëtua bijtë e Izraelit nga ndëshkimi poshtërues;

وَلَقَدْ نَجَّيْنَا بَنِي إِسْرَائِيلَ مِنَ الْعَذَابِ  
الْمُهِينِ ﴿٣١﴾

32. nga Faraoni. Ai ishte mizor dhe ishte nga ata që e tejkalojnë masën.

مَنْ فِرْعَوْنُ ۗ إِنَّهُ كَانَ عَلِيًّا مِّنَ  
الْمُسْرِفِينَ ﴿٣٢﴾

33. Ne i zgjodhëm ata në (të gjitha) botët për shkak të një dijeje.

وَلَقَدْ اخْتَرْنَاهُمْ عَلَىٰ عِلْمٍ عَلَىٰ الْعَالَمِينَ ﴿٣٣﴾

34. Dhe u dhamë disa shenja që kishin sprova të qarta.

وَأَتَيْنَهُم مِّنَ الْآيَاتِ مَا فِيهِ بَلَاءٌ مُّبِينٌ ﴿٣٤﴾

35. Pa dyshim, këta (pra, mekasit) thonë:

إِنَّ هَٰؤُلَاءِ لَيَقُولُونَ ﴿٣٥﴾

36. “Nuk ka vdekje tjetër përveç kësaj vdekjes sonë të parë dhe ne nuk do të ringjallemi.

إِنْ هِيَ إِلَّا مَوْتَتُنَا الْأُولَىٰ وَمَا نَحْنُ  
بِمُنشَرِينَ ﴿٣٦﴾

37. Na sillni, pra, baballarët tanë, nëse jeni të vërtetë!”

فَأْتُوا بِآبَائِنَا إِنْ كُنْتُمْ صَادِقِينَ ﴿٣٧﴾

38. A këta janë më të mirë apo populli i Tubbas dhe ata që ishin para tyre?<sup>2</sup> Ne i shkatërruam. Sigurisht, ata ishin fajtorë.

أَهُمْ خَيْرٌ أَمْ قَوْمُ تُبَّعٍ ۗ وَالَّذِينَ مِنْ  
قَبْلِهِمْ ۗ أَهْلَكْنَاهُمْ ۗ إِنَّهُمْ كَانُوا  
مُجْرِمِينَ ﴿٣٨﴾

39. Dhe Ne nuk i krijuam qiejt, tokën si dhe gjithçka që është mes tyre thjesht duke lozur.<sup>3</sup>

وَمَا خَلَقْنَا السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ وَمَا بَيْنَهُمَا  
لَعِينًا ﴿٣٩﴾

2. Tubba thuhet se është titulli mbretëror i mbretërve të Perandorisë Himjerite në Jemen. Mbretërit e Jemenit njiheshin me këtë titull kur edhe pushteti i tyre shtrihej mbi Himjerin, Hadrameutin dhe Shebën. Nga mbishkrimet e lashta duket se tubba-t sunduan mbi këto territore nga viti 270 e.s. deri në vitin 525 e.s.. Të dhënat historike flasin për madhështinë dhe despotizmin e tyre. Ata duket se e kishin shtrirë sundimin e tyre mbi të gjithë Arabinë, madje edhe në Afrikën Lindore (Enc. e Islamit). Tubba konkret, pra i përmendur në këtë ajet, mundet të ishte Profet i Zotit, siç përmendet edhe në disa hadithe të Profetit<sup>saws</sup>. Edhe Kurani duket se e mbështet këtë ide (50:15).

3. Jeta e njeriut ka një qëllim dhe një mision të madh. Aftësitë dhe fuqitë e mëdha që Zoti i ka

40. Nuk i kemi krijuar përveçse me të vërtetën, por shumica e njerëzve nuk dinë.

مَا خَلَقْنَاهُمْ إِلَّا بِالْحَقِّ وَلَكِنَّ أَكْثَرَهُمْ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٤٠﴾

41. Pa dyshim, Dita e Gjykimit është koha e caktuar për ata që të gjithë.

إِنَّ يَوْمَ الْفُضْلِ مِيقَاتُهُمْ أَجْمَعِينَ ﴿٤١﴾

42. Ditën kur asnjë shok nuk do t'i vlejë shokut tjetër aspak dhe ata as nuk do të ndihmohen.

يَوْمَ لَا يُغْنِي مَوْلَى عَنْ مَوْلَى شَيْئًا وَلَا هُمْ يُنصَرُونَ ﴿٤٢﴾

43. Përveç atij që e mëshiron Allahu. Sigurisht, Ai është i Plotfuqishmi, Mëshirëbërësi.

إِلَّا مَنْ رَحِمَ اللَّهُ ۗ إِنَّهُ هُوَ الْعَزِيزُ الرَّحِيمُ ﴿٤٣﴾

44. Njëmend, pema e *zekkumit*

إِنَّ شَجَرَتَ الرَّقُومِ ﴿٤٤﴾

45. është ushqimi i mëkatarit.<sup>4</sup>

طَعَامَ الْآثِمِينَ ﴿٤٥﴾

46. Është sikur bakri i shkrirë; do të vlejë në bark,

كَأَنَّهُمْ يَغْلَى فِي الْبُطُونِ ﴿٤٦﴾

47. sikur vlon uji i nxehtë.

كَغَلَى الْحَمِيمِ ﴿٤٧﴾

48. “Kapeni këtë dhe tërhiqeni zvarrë deri në mesin e xhehenemit!

خُذُوهُ فَاغْتَلُوهُ إِلَىٰ سَوَاءِ الْجَحِيمِ ﴿٤٨﴾

49. Më pas hidhini në kokë ndëshkimin prej uji të nxehtë!”

ثُمَّ صَبُّوا فَوْقَ رَأْسِهِ مِنْ عَذَابِ

الْحَمِيمِ ﴿٤٩﴾

50. “Shijoje! Ti për njëmend ishe ‘i plotfuqishëm, i nderuar!”

ذُقْ ۗ إِنَّكَ أَنْتَ الْعَزِيزُ الْكَرِيمُ ﴿٥٠﴾

51. Pikërisht kjo është ajo për të cilën ishit në mëdyshje.

إِنَّ هَذَا مَا كُنْتُمْ بِهِ تَمْتَرُونَ ﴿٥١﴾

dhuruar njeriut, janë një tregues i sigurt se jeta e tij nuk është e paqëllim. Pikërisht për këtë qëllim na tërheqin vëmendjen edhe krijimi i qiejve dhe i tokës.

4. Për pemën e *zekkumit*, lexoni 37:63-66.

52. Sigurisht, të druajturit (ndaj Zotit) do të jenë në një vend të sigurt.

إِنَّ الْمُتَّقِينَ فِي مَقَامٍ أَمِينٍ ﴿٥٢﴾

53. Në kopshte e burime.

فِي جَنَّاتٍ وَعُيُونٍ ﴿٥٣﴾

54. Të veshur me mëndafsh e kadife do të ulen përballë njëri-tjetrit.

يَلْبَسُونَ مِنْ سُندُسٍ وَإِسْتَبْرَقٍ  
مَّتَقِيلِينَ ﴿٥٤﴾

55. Kështu do të ndodhë. Do t'u japim bashkëshorte hyri symëdha.<sup>5</sup>

كَذَلِكَ نَقْدُ زَوْجَهُمْ بِحُورٍ عِينٍ ﴿٥٥﴾

56. Atje ata do të kërkojnë çdolloj frute duke (jetuar) në paqe.

يَدْعُونَ فِيهَا بِكُلِّ فَاكِهَةٍ آمِنِينَ ﴿٥٦﴾

57. Nuk do të shijojnë vdekjen në të, përveç vdekjes së parë, dhe Ai do t'i shpëtojë ata nga ndëshkimi i xhehenemit,<sup>6</sup>

لَا يَذُوقُونَ فِيهَا الْمَوْتَ إِلَّا الْمَوْتَةَ  
الْأُولَىٰ ۚ وَوَقَّهُمْ عَذَابَ الْجَحِيمِ ﴿٥٧﴾

58. si bekim prej Zotit tënd. Ky pikërisht është sukcesi madhështor!

فَضَلًّا مِّنْ رَبِّكَ ۗ ذَٰلِكَ هُوَ الْفَوْزُ  
الْعَظِيمُ ﴿٥٨﴾

59. Pa dyshim, Ne e kemi bërë të lehtë këtë (Kuran) në gjuhën tënde, që ata të kuptojnë këshillën.

فَإِنَّمَا يَسَّرْنَاهُ بِلِسَانِكَ لَعَلَّهُمْ يَتَذَكَّرُونَ ﴿٥٩﴾

60. Prandaj, prit ti; sigurisht, edhe ata janë duke pritur.

فَارْتَقِبْ إِنَّهُمْ مُّرْتَقِبُونَ ﴿٦٠﴾

5. Në ajetet 54 – 55 është përdorur një gjuhë figurative në bazë të asaj që njerëzit e pëlqejnë në këtë botë, por realitetin e tyre se si do të jenë në të vërtetë në botën tjetër, nuk e di askush.

6. Vdekja e atij besimtari që ka druajtje ndaj Zotit, nuk është si vdekje e humbur. Madje, besimtari jeton për hir të Zotit dhe vdes po për hir të Tij. Për këtë arsye, gjithçka që ai e humb për hir të Zotit, Zoti ia kthen sërish.

## Surja 45 – El-Xhathije

Surja El-Xhathije është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka tridhjetë e tetë ajete.

Ajeti i 14-të i kësaj sureje zbulon sekretet e universit në atë mënyrë që asnjë Libër tjetër qiellor i mëparshëm nuk ka një varg të tillë. Zoti i Madhërishtëm thotë në këtë ajet: Gjithçka që gjendet në tokë dhe nëpër qiej, Ai e ka nënshtruar për njeriun. Andaj, ata që meditojnë, do të kuptojnë se të gjithë trupat qiellorë ndikojnë te njeriu. Me fjalë të tjera, njeriu është një mikrokozmos dhe esencë e gjithë këtij universi gjigant.

Pasi pohon në një ajet që Kiameti do të ndodhë patjetër, kjo sure thotë: Njerëzit kur do të shohin shenja të llahtarshme të Kiametit, do të kenë përpara syve pasojat e veprave të tyre, andaj, do të gjunjëzohen të frikësuar, pra do të bëjnë sexhde përpara Madhësisë së Allahut, duke shpresuar që Ai t'i shpëtojë ata nga ndëshkimi i madh.

Më pas tha: Çdo *umet* do të gjykohet në bazë të Librit të tij, pra në bazë të Sheriatit që i është dhënë.

Ajeti i fundit i kësaj sureje edhe njëherë i tërheq vëmendjen njeriut që i gjithë universi është duke lavdëruar Allahun, Atij i takon Madhështia, Ai është Mbizotëruesi dhe i Urti.





1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. *Ha.Mim.* (I Lavdishëm, i Nde-ruar.)

حَوْرٍ ②

3. Zbritja e Librit është prej Allahut, Mbizotëruesit, të Urtit.

تَنْزِيلُ الْكِتَابِ مِنَ اللَّهِ الْعَزِيزِ الْحَكِيمِ ③

4. Pa dyshim, në qiej dhe në tokë ka shenja për besimtarët.

إِنَّ فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ لَآيَاتٍ

5. Edhe në krijimin tuaj, si dhe në gjallesat që Ai përhap, ka shenja për njerëzit që binden.

لِلْمُؤْمِنِينَ ④

وَفِي خَلْقِكُمْ وَمَا يَبْتُكُنُّ مِنْ دَابَّةٍ آيَاتٍ

لِقَوْمٍ يُوقِنُونَ ⑤

6. Dhe në ndërrimin e natës e të ditës, dhe në atë që Allahu zbret si ushqim prej qiellit e më pas përmes tij ringjall tokën pas vdekjes së saj, dhe në qarkullimin e erërave, ka shenja për njerëzit që logjikojnë.

وَاخْتِلَافِ اللَّيْلِ وَالنَّهَارِ وَمَا أَنْزَلَ اللَّهُ

مِنَ السَّمَاءِ مِنْ رِزْقٍ فَأَحْيَا بِهِ الْأَرْضَ

بَعْدَ مَوْتِهَا وَتَصْرِيفِ الرِّيْحِ آيَاتٍ لِقَوْمٍ

يَعْقِلُونَ ⑥

7. Këto janë ajetet e Allahut që Ne t'i lexojmë ty me të vërtetën. Atëherë, pas Allahut dhe ajeteve të Tij, cilën fjalë tjetër do të besojnë?<sup>1</sup>

تِلْكَ آيَاتُ اللَّهِ نَتْلُوهَا عَلَيْكَ بِالْحَقِّ ۗ فَبِأَيِّ

حَدِيثٍ بَعَدَ اللَّهُ وَأَيُّهُ يُؤْمِنُونَ ⑦

1. Në këtë ajet, në fjalët “pas Allahut dhe ajeteve të Tij, cilën fjalë tjetër do të besojnë?!” Kurani ka përdorur fjalën arabe “*hadith*”. Pra, “cilën *hadith* tjetër do të besojnë?!”. Fjala *hadith* ka kuptimin *thënie, lajm*, etj.. Muslimanët pikërisht këtë fjalë e përdorin edhe për thëniet e Profetit Muhammed<sup>saws</sup>. Kështu që, ky ajet ka edhe kuptimin që kur shikoni një “*hadith*” që kundërshton ajetet e Kuranit, nuk duhet ta besoni. Po, nëse gjendet një interpretim i tij në përputhje me fjalët e Kuranit, atëherë atë *hadith* duhet ta pranoni. Përveç kësaj, këtu fjala *hadith* duket se vjen edhe si profeci. Pra, do të vinte një kohë për *umetin* e muslimanëve, kur një pjesë e tyre do ta braktisnin Kuranin e Shenjtë duke i ndjekur ato “*hadithe*” që janë në kundërshtim me Kuranin e Shenjtë. Lexoni edhe 25:31.

8. U shkatërroftë çdo shpifës, mëkatar i madh!

وَيْلٌ لِّكُلِّ أَفَّاكٍ أَثِيمٍ ۝٨

9. Ai i dëgjon ajetet e Allahut që i lexohen atij, prapëseprapë këmbëngul me mendjemadhësi sikur nuk i ka dëgjuar ato. Jepi lajmin “e mirë” të një ndëshkimi të dhimbshëm!

يَسْمَعُ آيَاتِ اللَّهِ تُتْلَىٰ عَلَيْهِ ثُمَّ يُصِرُّ  
مُسْتَكْبِرًا كَانَ لَمْ يَسْمَعْهَا ۚ فَبَشِّرْهُ  
بِعَذَابٍ أَلِيمٍ ۝٩

10. Kur mëson diçka nga shenjat Tona, e merr për tallje. Të tillët do të kenë ndëshkim poshtërues.

وَإِذَا عَلِمَ مِنْ آيَاتِنَا شَيْئًا اتَّخَذَهَا هُزُوًا  
أُولَٰئِكَ لَهُمْ عَذَابٌ مُّهِينٌ ۝١٠

11. Pas tyre është xhehenemi. Atyre nuk do t'u vlejë aspak ajo që ata kanë punuar dhe (nuk do t'u vlejnjë) as miqtë që ata zgjodhën në vend të Allahut, dhe do të kenë një ndëshkim të rëndë.

مِنْ وَرَائِهِمْ جَهَنَّمُ ۚ وَلَا يُعْنَىٰ عَنْهُمْ مَا  
كَسَبُوا شَيْئًا وَلَا مَا اتَّخَذُوا مِنْ دُونِ  
اللَّهِ أَوْلِيَاءَ ۚ وَلَهُمْ عَذَابٌ عَظِيمٌ ۝١١

12. Ky është udhëzim. Dhe ata që mohuan ajetet e Zotit të tyre, do të kenë ndëshkim të llahtarshëm (e) të dhimbshëm.

هَٰذَا هُدًى ۚ وَالَّذِينَ كَفَرُوا بِآيَاتِ رَبِّهِمْ  
لَهُمْ عَذَابٌ مِّن رَّجْزٍ أَلِيمٍ ۝١٢

13. Allahu është Ai që nënshtroi për ju detin që anijet të lundrojnë në të me urdhrin e Tij, që ju të kërkonin bekimet e Tij dhe që të falënderoni.

اللَّهُ الَّذِي سَخَّرَ لَكُمُ الْبَحْرَ لِتَجْرِيَ  
الْفُلُكُ فِيهِ بِأَمْرِهِ وَتَبْتَغُوا مِنْ فَضْلِهِ  
وَلَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ ۝١٣

14. Dhe Ai nënshtroi për ju atë që është në qiej dhe atë që është në tokë, gjithçka prej Tij. Pa dyshim, në të ka shenja për njerëzit që mendojnë.

وَسَخَّرَ لَكُم مَّا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ  
جَمِيعًا مِنْهُ ۗ إِنَّ فِي ذَٰلِكَ لَآيَاتٍ لِّقَوْمٍ  
يَتَفَكَّرُونَ ۝١٤

15. Thuaju atyre që besuan që t'i falin ata që nuk shpresojnë ditët e Allahut, që Allahu të shpërblejë (çdo) popull sipas asaj që ka punuar.

قُلْ لِلَّذِينَ آمَنُوا يَغْفِرُوا لِلَّذِينَ لَا  
يَرْجُونَ أَيَّامَ اللَّهِ لِيَجْزِيَ قَوْمًا بِمَا كَانُوا  
يَكْسِبُونَ ۝١٥

16. Ai që bën mirë, e bën për veten e tij, dhe ai që bën keq, e bën kundër vetes së tij. Më pas te Zoti juaj do të ktheheni.

مَنْ عَمِلْ صَالِحًا فَلِنَفْسِهِ ۖ وَمَنْ أَسَاءَ  
فَعَلَيْهَا ۗ ثُمَّ إِلَىٰ رَبِّكُمْ تُرْجَعُونَ ﴿١٦﴾

17. Ne u dhamë bijve të Izraelit Librin, urtësinë dhe profetërinë, dhe i furnizuar me të pastrat dhe u dhamë epërsi mbi botët.<sup>2</sup>

وَلَقَدْ آتَيْنَا بَنِي إِسْرَائِيلَ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ  
وَالنُّبُوَّةَ وَرَزَقْنَاهُمْ مِّنَ الطَّيِّبَاتِ  
وَفَضَّلْنَاهُمْ عَلَى الْعَالَمِينَ ﴿١٧﴾

18. U dhamë mësimë të qarta të Sheriatit. Ata nuk ranë në kundërshti, përveçse për shkak të rebelimit ndaj njëri-tjetrit, pasi u kishte ardhur dija. Sigurisht, Zoti yt do të gjykojë mes tyre Ditën e Kiametit për çështjet në të cilat ata kundërshtojnë.

وَأْتَيْنَاهُم بِبَيِّنَاتٍ مِّنَ الْأَمْرِ ۚ فَمَا اخْتَلَفُوا  
إِلَّا مِّنْ بَعْدِ مَا جَاءَهُمُ الْعِلْمُ بَعِيَا بَيْنَهُمْ ۗ  
إِنَّ رَبَّكَ يَقْضِي بَيْنَهُمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ فِيمَا  
كَانُوا فِيهِ يَخْتَلِفُونَ ﴿١٨﴾

19. Më pas ty të vendosëm mbi një Sheriat të dekretuar.<sup>3</sup> Ndiqe atë dhe mos ndiq dëshirat e atyre që nuk dinë.

ثُمَّ جَعَلْنَاكَ عَلَىٰ شَرِيعَةٍ مِّنَ الْأَمْرِ فَاتَّبِعْهَا  
وَلَا تَتَّبِعْ أَهْوَاءَ الَّذِينَ لَا يَعْلَمُونَ ﴿١٩﴾

20. Ata kurrë nuk do të vlejnë për ty aspak përballë Allahut. Njëmend, të padrejtët janë miq të njëri-tjetrit, kurse Allahu është Miku i të druajturve (ndaj Tij).

إِنَّهُمْ لَن يُّغْنُوا عَنْكَ مِنَ اللَّهِ شَيْئًا ۗ وَإِنَّ  
الظَّالِمِينَ بَعْضُهُمْ أَوْلِيَاءُ بَعْضٍ ۗ وَاللَّهُ وَلِيٌّ  
الْمُتَّقِينَ ﴿٢٠﴾

21. Këto janë dritësime për njerëzit, udhëzim dhe mëshirë për popullin që beson me bindje.

هَذَا بَصَائِرُ لِلنَّاسِ وَهُدًى وَرَحْمَةٌ لِّقَوْمٍ  
يُّوقِنُونَ ﴿٢١﴾

2. Fjalët “u dhamë epërsi mbi botët” nënkuptojnë që Allahu u dha epërsi Bijve të Izraelit mbi të gjitha botët që ishin të njohura atëherë. Bijtë e Izraelit natyrisht që nuk kishin asnjë njohuri për shumë pjesë të botës. Kështu që, Allahu u kishte dhënë epërsi bijve të Izraelit mbi të gjitha botët që ata kishin njohur.

3. Pas bijve të Izraelit, Allahu i Madhërishëm i dha Sheriat Profetit Muhammed<sup>savs</sup> dhe, ngaqë ai ishte Profet për mbarë botën, edhe Sheriati i tij është për të gjithë botën.

22. Ata që korrën të këqija, a mendojnë se do t'i bëjmë sikur ata që besuan dhe bënë të mira, (që) jeta dhe vdekja e tyre të jetë njësoj? Sa keq që gjykojnë!

23. Allahu krijoi qiejt dhe tokën me të vërtetën, që të shpërblejë çdo shpirt për atë që ka punuar, dhe atyre nuk do t'u bëhet padrejtësi.

24. A ke parë atë që dëshirën e vet e merr për ta adhuruar, dhe Allahu e devijon atë për shkak të një dijeje, ia vulos dëgjimin dhe zemrën dhe i vë perde shikimit të tij?! Pra, kush e udhëzon dot atë pas Allahut?! A nuk pranoni këshillën?!

25. Dhe thonë: “Nuk ka (jetë) përveç jetës së kësaj bote; vdesim e jetojmë dhe asgjë nuk na shkatërron përveç kohës!” Ndërkohë, ata nuk kanë aspak dije për këtë; ata vetëm hamendësojnë.

26. Kur atyre u lexohen ajetet Tona të qarta, nuk kanë asnjë argument tjetër përveçse thonë: “Na sillni baballarët tanë, nëse jeni të vërtetë!”

27. Thuaj: Allahu ju jep jetë, më pas ju jep vdekje dhe më pas do t'ju mbledhë për Ditën e Kiametit në të cilën nuk ka asnjë dyshim. Por shumica e njerëzve nuk dinë.

أَمْ حَسِبَ الَّذِينَ اجْتَرَحُوا السَّيِّئَاتِ أَنْ  
نَجْعَلَهُمْ كَالَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ  
سَوَاءً مَجْيَاهُمْ وَمَمَائِهِمْ ۗ سَاءَ مَا  
يَحْكُمُونَ ﴿٢٢﴾

وَحَاقَ اللَّهُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ بِالْحَقِّ  
وَلَيُجْزَىٰ كُلُّ نَفْسٍ بِمَا كَسَبَتْ وَهُمْ  
لَا يُظْلَمُونَ ﴿٢٣﴾

أَفَرَأَيْتَ مَنِ اتَّخَذَ إِلَهَهُ هَوَاهُ وَأَصْلَهُ  
اللَّهُ عَلَىٰ عِلْمٍ وَوَحَّمَ عَلَىٰ سَمْعِهِ وَقَلْبِهِ  
وَجَعَلَ عَلَىٰ بَصَرِهِ غِشَاةً فَمَنْ يَهْدِيهِ  
مِنْ بَعْدِ اللَّهِ أَفَلَا تَذَكَّرُونَ ﴿٢٤﴾

وَقَالُوا مَا هِيَ إِلَّا حَيَاتُنَا الدُّنْيَا نَمُوتُ  
وَنَحْيَا وَمَا يُهْلِكُنَا إِلَّا الدَّهْرُ ۗ وَمَا لَهُمْ  
بِذَلِكَ مِنْ عِلْمٍ ۗ إِنْ هُمْ إِلَّا يَظُنُّونَ ﴿٢٥﴾

وَإِذَا تُلِيٰ عَلَيْهِمْ آيَاتُنَا بَيِّنَاتٍ مَا كَانَ  
حُجَّتَهُمْ إِلَّا أَنْ قَالُوا اتُّوا بِآبَائِنَا إِنْ  
كُنْتُمْ صَادِقِينَ ﴿٢٦﴾

قُلِ اللَّهُ يُحْيِيكُمْ ثُمَّ يُمِيتُكُمْ ثُمَّ  
يَجْمَعُكُمْ إِلَىٰ يَوْمِ الْقِيَامَةِ لَا رَيْبَ فِيهِ  
ۗ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٢٧﴾

28. Allahut i përket sundimi i qiejve dhe i tokës. Dhe ditën kur do të vendoset Ora, atë ditë do të humbasin gënjeshtarët.

وَلِلَّهِ مُلْكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ۗ وَيَوْمَ  
تَقُومُ السَّاعَةُ يُومِذِنُ يَحْسِرُ الْمُبْطِلُونَ ﴿٢٨﴾

29. Dhe ti do të shohësh çdo popull të gjunjëzuar. Çdo popull do të thirret drejt Librit të tij. “Sot do të shpërbleheni për atë që bënit.

وَتَرَى كُلَّ أُمَّةٍ جَائِيَةً ۖ كُلُّ أُمَّةٍ تُدْعَى  
إِلَىٰ كِتَابِهَا ۗ الْيَوْمَ تُجْرَوْنَ مَا كُنتُمْ  
تَعْمَلُونَ ﴿٢٩﴾

30. Ky është Libri ynë që do të flasë kundër jush me vërtetësi. Ne shënonim çdo gjë që bënit.”

هَذَا كِتَابُنَا يُنطِقُ عَلَيْكُمْ بِالْحَقِّ ۗ إِنَّا كُنَّا  
نَسْتَسْمِعُ مَا كُنتُمْ تَعْمَلُونَ ﴿٣٠﴾

31. Atëherë ata që besuan dhe bënë të mira, Zoti i tyre do t'i marrë në mëshirën e Tij. Ky pikërisht është suksesi i qartë.

فَأَمَّا الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ  
فَيُدْخِلُهُمْ رَبُّهُمْ فِي رَحْمَتِهِ ۗ ذَٰلِكَ هُوَ  
النُّفُورُ الْمُبِينُ ﴿٣١﴾

32. Kurse atyre që mohuan (do t'u thuhet): “A nuk ju lexoheshin ajetet e Mia?! E ju sërish u treguat mendjemëdhenj dhe ishit një popull fajtor!”

وَأَمَّا الَّذِينَ كَفَرُوا ۖ أَفَلَمْ تَكُنْ أَلَيْسَ  
تُتْلَىٰ عَلَيْكُمْ فَاسْتَكْبَرْتُمْ وَكُنتُمْ قَوْمًا  
مُّجْرِمِينَ ﴿٣٢﴾

33. Dhe kur thuhej: “Premtimi i Allahut pa dyshim është i vërtetë dhe se nuk ka aspak dyshim në Orën”, thoshit: “Nuk dimë ç'ka është Ora; ne nuk mendojmë më tepër se hamendje dhe nuk bindemi”.

وَإِذَا قِيلَ إِنَّ وَعْدَ اللَّهِ حَقٌّ ۖ وَالسَّاعَةُ  
لَأَرْبَبَ فِيهَا قُلُوبُ مَا نَدْرِي مَا السَّاعَةُ ۗ  
إِنْ نَّظُنُّ إِلَّا ظَنًّا ۖ وَ مَا نَحْنُ  
بِمُسْتَيْقِنِينَ ﴿٣٣﴾

34. Atyre do t'u zbulohen të këqijat që ata bënë dhe do t'i rrethojë ajo që ata përqeshnin.

وَبَدَأَهُمْ سَيِّئَاتٍ مَا عَمِلُوا وَحَاقَ بِهِمْ مَا  
كَانُوا بِهِ يَسْتَهْزِءُونَ ﴿٣٤﴾

35. Dhe do t'u thuhet: “Sot Ne do t'ju harrojmë ashtu siç ju e kishit harruar takimin e kësaj dite; streha juaj do të

وَقِيلَ الْيَوْمَ نَنسِيكُمْ كَمَا نَسِيتُمْ لِقَاءَ  
يَوْمِكُمْ هَٰذَا وَمَأْوَاكُمُ النَّارُ وَمَا لَكُمُ

jetë zjarri dhe ju nuk do të keni asnjë ndihmës.

مَنْ نُصْرَيْنَ ﴿٥٦﴾

36. Kjo për arsye se ju i morët për tallje shenjat e Allahut dhe ju mashtroi jeta e dynjasë.” Andaj, sot ata nuk do të nxirren prej tij (pra, prej zjarrit) dhe as nuk do të mund të kërkojnë falje.

ذِكُّكُمْ بِأَنكُمُ اتَّخَذْتُمْ آيَاتِ اللَّهِ هُزُوًا  
وَأَعْرَبْتُمْ كَلِمَاتِ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا ۗ فَأَلَيَوْمَ لَا  
يُخْرَجُونَ مِنْهَا وَلَا هُمْ يُسْتَعْتَبُونَ ﴿٥٦﴾

37. Pra, Allahut i përket lavdia, Zotit të qiejve dhe Zotit të tokës, Zotit të botëve.

فَلِلَّهِ الْحَمْدُ رَبِّ السَّمَوَاتِ وَرَبِّ الْأَرْضِ  
رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿٥٧﴾

38. Dhe Atij i përket madhështia në qiej e tokë dhe Ai është Mbizotëruesi, i Urti.

وَلَهُ الْكِبْرِيَاءُ فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ  
ۗ وَهُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ﴿٥٨﴾

## Surja 46 – El-Ahkaf

Surja El-Ahkaf është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka tridhjetë e gjashtë ajete.

Kjo sure që në fillim deklaroi të vërtetën absolute, që u përmend në ajetet e fundit të sures paraardhëse. Atje ishte thënë se e gjithë lavdia është e Allahut, Zotit të qiejve, të tokës dhe të gjithçkaje që gjendet në to, kurse kjo sure pohon: Qiejt dhe toka dhe gjithçka që është në to, janë krijuar për t'i shërbyer së vërtetës. Me një fjalë, i gjithë universi dëshmon vetëm Zotin e Madhërishëm që është e Vërteta Absolute. Pas kësaj, duke iu drejtuar idhujtarëve, thotë: Qiejt, toka dhe gjithçka që është mes tyre janë krijuar i Allahut; sillni edhe ju ndonjë krijim të zotave tuaj! Në të vërtetë, kjo sfidë ka një argument të nënkuptuar: çdo krijim e ka stemën e Krijuesit të tij dhe Ai është Një dhe i Vetëm.

Ndonëse kjo sure përmend shkatërrimet e popujve të mëparshëm si populli i Adit, të cilëve u ishte dhënë paralajmërimi të *Ahkafi* (Dunat), por nuk duhet të harrojmë që është metoda e Kuranit të Shenjtë që me përmendjen e historive të të parëve, ai parashikon ngjarje të ngjashme edhe për të ardhmen.

Kjo sure edhe një herë sjell temën e *Dukhanit* (Tymi) duke përmendur disa kategori njerëzish se sa herë që u përhijojnë “retë”, ata mendojnë se do t'u zbresin bekime prej qiellit, por sapo këto re do t'u afrohen, në vend të bekimeve, ato do t'u lëshojnë një erë që do të shkatërrojë gjithçka. Kjo erë në fakt nënkupton rrezatimin radioaktiv të luftërave të mëdha që do të bëheshin në këtë kohë. Në këtë situatë, banorët nuk do të kenë mundësi të dalin nga banesat e tyre, dhe e vetmja gjë që do të mbetet për të dëshmuar se ata kishin ekzistuar, do të jenë rrënojat e vendbanimeve të tyre. Hiroshima dhe Nagasaki janë dëshmitare të këtij fakti.

Ajeti nr. 34 pohon: A nuk shohin ata se Allahu nuk lodhet nga krijimi i qiejve dhe i tokës?! Njeriu i kohës në të cilën u zbrit Kurani, nuk mund ta shikonte dot këtë, por njeriu i kohës së sotme që bën të gjitha përpjekjet për të zbuluar sekretet e Tokës e të qiellit, e di fenomenin që universi fundoset në asgjësim, për të dalë sërish në dritë një univers i ri. Kjo përsëritje e asgjësimit dhe e krijimit është vepër e tillë e Zotit të Madhërishëm, e cila tregon që Ai kurrë nuk lodhet nga krijimi. Atëherë, si mund të mendojë njeriu që pas vdekjes së tij, Zoti nuk paska mundësi ta rikrijë atë?! [Për më shumë, lexoni 21:105].

1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ ①

2. *Ha.Mim.* (I Lavdishëm, i Nde-ruar.)

ح م ①

3. Zbritja e Librit është prej Allahut, Mbizotëruesit, të Urtit.

تَنْزِیْلُ الْكِتٰبِ مِنَ اللّٰهِ الْعَزِیْزِ الْحَكِیْمِ ①

4. Nuk i krijuam qiejt, tokën dhe gjithçka që gjendet mes tyre, përveçse me vërtetësinë dhe për një afat të caktuar. Ata që mohuan, i shmangen asaj për të cilën janë paralajmëruar.

مَا خَلَقْنَا السَّمٰوٰتِ وَالْاَرْضَ وَمَا بَیْنَهُمَا اِلَّا بِالْحَقِّ وَاَجَلٍ مُّسَمًّى ۗ وَالَّذِیْنَ كَفَرُوْا عَمَّاۤ اُنذِرُوْا مُعْرِضُوْنَ ①

5. Thuaj: A keni menduar për ata, të cilëve u luteni në vend të Allahut? Tregomëni çfarë kanë krijuar ata prej tokës, apo mos vallë ortakëria e tyre është vetëm në qiej?! Sillmëni ndonjë Libër që ka qenë përpara këtij (Libri), ose ndonjë gjurmë të dijes, në qoftë se jeni të vërtetë.

قُلْ اَرَءَیْتُمْ مَا تَدْعُوْنَ مِنْ دُوْنِ اللّٰهِ اُرُوْنِیْ مَاذَا خَلَقُوْا مِنَ الْاَرْضِ اَمْ لَهُمْ شِرْكٌ فِی السَّمٰوٰتِ ۗ اِیْتُوْنِیْ بِكِتٰبٍ مِّنْ قَبْلِ هٰذَا اَوْ اَثَرٍ مِّنْ عِلْمٍ اِنْ كُنْتُمْ صٰدِقِیْنَ ①

6. Kush mund të jetë më i devijuar sesa ai, i cili, duke e lënë Allahun, u lutet atyre që nuk i përgjigjen dot deri në Ditën e Kiametit?! Këta janë të pavetëdijshëm ndaj lutjeve të tyre.

وَمَنْ اَصْلٌ مِّمَّنْ یَّدْعُوْا مِنْ دُوْنِ اللّٰهِ مَنْ لَا یَسْتَجِیْبُ لَهٗ اِلٰی یَوْمِ الْقِیٰمَةِ وَهُمْ عَنِ دَعَاۤیِهِمْ غٰفِلُوْنَ ①

7. Dhe kur do të tubohen njerëzit, po këta do t'u bëhen armiq dhe do t'ua mohojnë (edhe) adhurimin.

وَاِذَا حُشِرَ النَّاسُ كَانُوْا لَهُمْ اَعْدَآءٌ وَّكَانُوْا بِعِبَادَتِهِمْ كٰفِرِیْنَ ①



8. Kur u lexohen ajetet Tona shumë të qarta, ata që e mohuan të vërtetën pasi u erdhi ajo, thonë: “Kjo qenka një magji e hapur!”

9. A thonë se ai e trilloi atë? Thuaj: Po ta kisha trilluar këtë, ju nuk do të kishit fuqi aspak që të më shpëtonit mua prej Allahut. Ai e di më së miri atë në të cilën jeni të angazhuar; Ai është i mjaftueshëm si Dëshmitar mes meje e jush, dhe Ai është Falësi, Mëshirëbërësi.

10. Thuaj: “Unë nuk jam rasti i parë mes të Dërguarve, dhe nuk di se çfarë do të ndodhë as me mua e as me ju. Unë e ndjek vetëm atë që më shpallet, dhe unë nuk jam asgjë veçse një alarmues i qartë.”

11. Thuaj: Si mendoni, nëse ky (Profet) është prej Allahut, dhe ju e keni mohuar atë, edhe pse një dëshmitar nga bijtë e Izraelit dëshmoi për të ngjashmin e tij, pra ai vetë besoi (në të), kurse ju jeni treguar mendjemëdhenj! Sigurisht, Allahu nuk e udhëzon popullin keqbërës.<sup>1</sup>

وَإِذَا تُلِيٰ عَلَيْهِمُ آيَاتُنَا بِآيَاتِنَا قَالَ الَّذِينَ  
كَفَرُوا بِالْحَقِّ لَمَّا جَاءَهُمْ هَذَا سِحْرٌ  
مُّبِينٌ ۝٨

أَمْ يَقُولُونَ افْتَرَاهُ ۗ قُلْ إِنِ افْتَرَيْتُهُ  
فَلَا تَمْلِكُونَ لِي مِنَ اللَّهِ شَيْئًا ۗ هُوَ أَعْلَمُ  
بِمَا تُفِيضُونَ فِيهِ ۗ كَفَىٰ بِهِ شَهِيدًا بَيْنِي  
وَبَيْنَكُمْ ۗ وَهُوَ الْعَفْوَورُ الرَّحِيمُ ۝٩

قُلْ مَا كُنْتُ بِدَعَا مِنَ الرَّسْلِ وَمَا أَدْرِى  
مَا يُفْعَلُ بِي وَلَا بِكُمْ ۗ إِنِ أَسْئَعُ إِلَّا  
مَا يُوحَىٰ إِلَيَّ وَمَا أَنَا إِلَّا نَذِيرٌ مُّبِينٌ ۝١٠

قُلْ أَرَأَيْتُمْ إِنْ كَانَ مِنْ عِنْدِ اللَّهِ  
وَكَفَرْتُمْ بِهِ وَشَهِدَ شَاهِدٌ مِّنْ بَنِي  
إِسْرَائِيلَ عَلَىٰ مِثْلِهِ فَأَمَنَ وَاسْتَكْبَرْتُمْ ۗ  
إِنَّا لِلَّهِ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الظَّالِمِينَ ۝١١

1. Në këtë ajet, me “dëshmitar” nënkuptohet *Hazret Musai*<sup>as</sup> dhe “besimi” i tij do të thotë se për sa kohë që dha dëshminë për ardhjen e Profetit Muhammed<sup>sav</sup>, ai besoi në të. Kjo dëshmi gjendet në Bibël ku Zoti i thotë *Hazret Musait*<sup>as</sup>: “unë do të nxjerr për ta një profet nga gjiri i vëllezërve të tyre dhe do të vë në gojën e tij fjalët e mia, dhe ai do t’u thotë atyre të gjitha ato që unë do t’i urdhëroj. Dhe do të ndodhë që nëse dikush nuk i dëgjon fjalët e mia që ai thotë në emrin tim, unë do t’i kërkoj llogari.” (Bibla, Ligji i Përtërirë 18:18-19). Kurse fjalët “u treguat mendjemëdhenj” u referohen atyre bijve të Izraelit që e mohuan Profetin Muhammed<sup>sav</sup>. Me fjalë të tjera, Zoti i Madhërishtëm u tha: Ju po e mohoni Profetin Muhammed, kurse vetë Udhëheqësi i *umetit* tuaj ka besuar në të, dhe se ky zakoni i mohimit në mënyrë të përsëritur vjen për shkak të mendjemadhësisë suaj.

12. Ata që mohuan thanë për ata që besuan: “Nëse kjo do të ishte (diçka) e mirë, ata nuk do të na kishin parakaluar për ta marrë atë”. E tani që nuk u udhëzuan dot përmes saj, (prej dështimit dhe inatit) patjetër do të thonë: “Kjo qenka një gënjeshtër e vjetër!”

13. Përpara kësaj ishte edhe Libri i Musait si udhërrëfyes dhe mëshirë. Ndërsa ky është një Libër vërtetues në një gjuhë shumë elokuate, që t’i alarmojë ata që bënë të këqija dhe që të jetë lajm i mirë për mirëbërësit.

14. Pa dyshim, ata që thanë: “Zoti ynë është Allahu”, më pas treguan qëndrueshmëri, nuk do të kenë asnjë frikë dhe as nuk do të brengosen.

15. Këta janë banorë të xhenetit, në të cilin do të jetojnë përgjithmonë, si shpërblim i asaj që ata punonin.

16. Ne e porositëm njeriun të jetë mirëbërës ndaj prindërve të tij. Nëna e tij e mbarti atë me vështirësi dhe e lindi me vështirësi. Mbartja dhe gjdhënia për të janë tridhjetë muaj. Kur ai arriti pjekurinë e tij dhe arriti moshën dyzetvjeçare, tha: “O Zoti im! Më mundëso të Të falënderoj për bekimin që më dhe mua dhe prindërve të mi, të bëj të mirat që Ti i pëlqen, dhe m’i përmirëso edhe fëmijët! Me të vërtetë, unë kthehem i penduar te Ti dhe pa dyshim, jam

وَقَالَ الَّذِينَ كَفَرُوا لِلَّذِينَ آمَنُوا لَوْ كَانَ خَيْرًا مَّا سَبَقُونَا إِلَيْهِ ۖ وَإِذْ لَمْ يَهْتَدُوا بِهِ فَيَقُولُونَ هَذَا آفَكٌ قَدِيمٌ ﴿١٢﴾

وَمِنْ قَبْلِهِ كَتَبَ مُوسَىٰ إِمَامًا وَرَحْمَةً ۗ وَهَذَا كِتَابٌ مُّصَدِّقٌ لِّسَانًا عَرَبِيًّا يُبَيِّنُ لِلَّذِينَ ظَلَمُوا ۗ وَبُشْرَىٰ لِلْمُحْسِنِينَ ﴿١٣﴾

إِنَّ الَّذِينَ قَالُوا رَبُّنَا اللَّهُ ثُمَّ اسْتَقَامُوا فَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ ﴿١٤﴾

أُولَٰئِكَ أَصْحَابُ الْجَنَّةِ خَالِدِينَ فِيهَا ۗ جَزَاءً بِمَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿١٥﴾

وَوَصَّيْنَا الْإِنْسَانَ بِوَالِدَيْهِ إِحْسَانًا ۗ حَمَلَتْهُ أُمُّهُ كُرْهًا وَوَضَعَتْهُ كُرْهًا ۗ وَحَمَلُهُ وَفِصْلُهُ ثَلَاثُونَ شَهْرًا ۗ حَتَّىٰ إِذَا بَلَغَ أَشُدَّهُ وَبَلَغَ أَرْبَعِينَ سَنَةً ۗ قَالَ رَبِّ أَوْزِعْنِي أَنْ أَشْكُرَ نِعْمَتَكَ الَّتِي أَنْعَمْتَ عَلَيَّ وَعَلَىٰ وَالِدَيَّ وَأَنْ أَعْمَلَ صَالِحًا تَرْضَاهُ وَأَصْلِحْ لِي فِي ذُرِّيَّتِي ۗ

ndër të nënshtruarit.”<sup>2</sup>

17. Këta janë ata të cilëve Ne do t’ua pranojmë më të mirën që ata kanë punuar dhe do t’ua anashkalojmë të këqijat, (e që) do të jenë me banorët e xhenetit. Premtim i vërtetë që atyre u jepet.

18. Dhe ai që u tha prindërve të tij: “Mjerë ju! A po më frikësoni që do të nxirrem (nga varri për t’u ringjallur), ndërkohë shumë popuj kanë kaluar para meje?!” Dhe të dy (prindërit) duke i kërkuar ndihmë Allahut, i thonë (djalit): “Mjerë ti! Beso! Premtimi i Allahut pa dyshim është i vërtetë”, por ai u thotë: “Këto janë vetëm përrallat e të parëve!”

19. Këta janë ata për të cilët u vërtetua fjala (siç u vërtetua edhe) për popujt që kaluan para tyre, nga xhindët dhe njerëzit. Njëmend, ata janë humbës.

إِنِّي تُبْتُ إِلَيْكَ وَإِنِّي مِنَ الْمُسْلِمِينَ ⑩

أُولَئِكَ الَّذِينَ نَتَقَبَّلُ عَنْهُمْ أَحْسَنَ مَا  
عَمِلُوا وَنَتَجَاوَزُ عَنْ سَيِّئَاتِهِمْ فِي أَصْحَابِ  
الْجَنَّةِ ۗ وَعَدَّ الصِّدْقِ الَّذِي كَانُوا  
يُوعَدُونَ ⑪

وَالَّذِي قَالَ لِوَالِدَيْهِ أُفٍّ لَّكُمَا  
أَتَعِدُنِي أَنْ أُحْرَجَ وَقَدْ خَلَتِ الْقُرُونُ  
مِنْ قَبْلِي ۗ وَهُمَا يَسْتَعِثَّانِ اللَّهَ وَبِئْسَ  
أَمْرٌ ۚ إِنَّ وَعْدَ اللَّهِ حَقٌّ ۖ فَيَقُولُ مَا هَذَا  
إِلَّا أَسَاطِيرُ الْأَوَّلِينَ ⑫

أُولَئِكَ الَّذِينَ حَقَّ عَلَيْهِمُ الْقَوْلُ فِي أَمْرٍ  
قَدْ خَلَتْ مِنْ قَبْلِهِمْ مِنَ الْجِنِّ وَالْإِنْسِ ۗ  
إِنَّهُمْ كَانُوا خَسِرِينَ ⑬

2. Gjatë rinisë njeriu shumë pak i frikësohet Zotit dhe shpesh i ndizen epushet dhe e pushton instinkti, madje ai nuk ia vë veshin asnjë këshilltari. Mirëpo, kur arrin të dyzetat dhe flokët e rinisë fillojnë t’i thinjen, ai pendohet për të gjitha gabimet e bëra, për të cilat këshilltarët qenë lodhur pas tij. Tundimet e shpirtit fillojnë t’i ulen vetvetiu, sepse sipas gjendjes fizike i afrohet edhe moshë e pleqërisë dhe ai nuk do ta ketë më atë marrëzinë e rinisë që kishte më parë. Po kështu, në këtë moshë, ai sheh vdekjen e shumë të mëdhenjve, e madje nganjëherë për shkak të caktimit të Zotit, edhe të të vegjëlve, gjë që atij ia këput shpirtin, dhe kështu ai e dëshmon paqëndrueshmërinë e kësaj bote në forma të ndryshme dhe Zoti i vë një pasqyrë përpara duke i thënë – Ja, kjo është gjithë historia e kësaj dynjaje, për të cilën ti vdes! Kështu, atij i vjen shumë keq për të gjitha gabimet që kishte bërë gjer atëherë dhe pëson një revolucion të ndjeshëm në jetën e tij, duke nisur një botë të re, me kusht që brumi i tij të ketë mirësi dhe ai të jetë ndër ata që janë thirrur prej Zotit. Shumë nga Profetët e mëdhenj janë shfaqur pikërisht në këtë moshë. Madje, prijësi dhe udhëheqësi ynë, i zgjedhuri *Hazret Muhammedi*<sup>savs</sup> në moshën dyzetvjeçare u caktua si Reformator i njerëzimit.

20. Për të gjithë ka grada në bazë të asaj që ata punojnë, që (Allahu) t'ua shpërblejë plotësisht veprat e tyre, pa iu bërë padrejtësi.

وَلِكُلِّ دَرَجَاتٍ مِّمَّا عَمِلُوا ۖ وَلِيُوَفِّيَهُمْ  
أَعْمَالَهُمْ وَهُمْ لَا يُظْلَمُونَ ﴿٢٠﴾

21. Ditën kur ata që mohuan, do të sillen përpara zjarrit (e do t'u thuhet): “I keni mbaruar të mirat tuaja që në jetën e dynjasë dhe keni marrë përfitim të përkohshëm të tyre; andaj, sot do t'ju jepet ndëshkim poshtërues për shkak se tregoheshit mendjemëdhenj në tokë pa të drejtë dhe për shkak se ishit të pabindur.”

وَيَوْمَ يُعْرَضُ الَّذِينَ كَفَرُوا عَلَى النَّارِ ۗ  
أَذْهَبْتُمْ طَيْبَاتِكُمْ فِي حَيَاتِكُمُ الدُّنْيَا  
وَأَسْتَعْتَمْتُمْ بِهَا ۖ فَالْيَوْمَ تُجْرَوْنَ عَذَابَ  
الْهُونِ بِمَا كُنْتُمْ تَسْتَكْبِرُونَ فِي الْأَرْضِ  
بِغَيْرِ الْحَقِّ ۗ وَبِمَا كُنْتُمْ تَفْسُقُونَ ﴿٢١﴾

22. Kujto edhe vëllain e (popullit) ad, kur ai alarmoi popullin e tij te dunat – ndonëse edhe para tij, edhe pas tij pati alarmimet –, që “mos adhuroni tjetërkënd pos Allahut; unë përnjëmend frikësohem nga ndëshkimi i një dite të rëndë mbi ju.”

وَأذْكُرَ آخَا عَادٍ إِذْ أَنْذَرَ قَوْمَهُ  
بِالْأَحْقَافِ وَقَدْ خَلَّتِ النَّذُرُ مِنْ بَيْنِ  
يَدَيْهِ وَمِنْ خَلْفِهِ ۖ أَلَّا تَعْبُدُوا إِلَّا اللَّهَ ۗ  
إِنِّي أَخَافُ عَلَيْكُمْ عَذَابَ يَوْمٍ عَظِيمٍ ﴿٢٢﴾

23. Ata thanë: “A na erdhe për të na larguar nga zotat tanë?! Na sill atë për të cilën na paralajmëron, nëse je ndër të vërtetët!”

قَالُوا أَجِئْنَا بِتَأْفِكِنَا عَنِ الْهَيْبَةِ ۗ فَأْتِنَا بِمَا  
تَعِدُنَا إِنْ كُنْتَ مِنَ الصَّادِقِينَ ﴿٢٣﴾

24. Ai tha: “Sigurisht, dija është tek Allahu, kurse unë jua kumtoj mesazhin me të cilin jam dërguar, por ju shoh që jeni një popull i paditur.”

قَالَ إِنَّمَا الْعِلْمُ عِنْدَ اللَّهِ ۗ وَأُبَلِّغُكُمْ مَا  
أُرْسِلْتُ بِهِ ۖ وَلَكِنِّي أَرَأَيْتُمْ قَوْمًا  
تَجْهَلُونَ ﴿٢٤﴾

25. Dhe kur e panë atë në formën e një reje që po vinte drejt lëndinave të tyre, thanë: “Kjo është një (copë) reje që do të na lëshojë shi.” “Jo! Është ajo që ju po e kërkonit me nxitim; një shakullinë me një ndëshkim të dhimbshëm;

فَلَمَّا رَأَوْهُ عَارِضًا مُسْتَقِيلًا ۖ أودِيَتْهُمْ ۗ  
قَالُوا هَذَا عَارِضٌ مُمَطَّرْنَا ۗ بَلْ هُوَ مَا  
اسْتَعْجَلْتُمْ بِهِ ۗ رِيحٌ فِيهَا عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿٢٥﴾

26. shkatërron çdo gjë me urdhrin e Zotit të saj.” Dhe mëngjesi i gjeti në atë mënyrë që aty nuk shihej asgjë përveç vendbanimeve të tyre. Ne kështu e dënojmë popullin fajtor.

27. Sigurisht, Ne i fuqizuar ata sa nuk ju kemi fuqizuar ju, dhe u dhamë dëgjim, shikim e zemra, por kur ata i kundërshtonin (me kokëfortësi) shenjat e Allahut, nuk u vlejten aspak as dëgjimi, as shikimi e as zemrat e tyre, dhe i rrethoi ajo që ata e përqeshnin.

28. Sigurisht, Ne i shkatërruam vendbanimet që ishin rreth jush. Dhe ua shpjeguam shenjat vazhdimisht, që ata të tërhiqeshin.

29. E pse nuk i ndihmuam dot zotat që këta i kishin marrë përveç Allahut, duke kërkuar afrimin (e Tij) përmes tyre?! Madje, u humbën. Dhe kjo ishte rrjedhojë e gënjeshtres së tyre dhe e asaj që ata trillonin.

30. Dhe (kujto) kur Ne kthyem te ti një grup të xhindëve që kërkonin të dëgjonin Kuran. Kur ata erdhën pranë tij, thanë: “Heshtni!” E kur mbaroi, u kthyen te populli i tyre duke duke qenë paralajmërues.<sup>3</sup>

تُدْمِرُ كُلَّ شَيْءٍ بِأَمْرِ رَبِّهَا فَاصْبَحُوا  
لَا يَرَى إِلَّا مَسَكِنَتَهُمْ ۗ كَذَلِكَ نَجْزِي  
الْقَوْمَ الْمُجْرِمِينَ ﴿٢٦﴾

وَلَقَدْ مَكَّنَّهُمْ فِيْمَا إِن مَكَّنَّاكُمْ فِيهِ  
وَجَعَلْنَا لَهُمْ سَمْعًا وَ أَبْصَارًا وَ أَفْئِدَةً ۗ فَمَا  
أَغْنَىٰ عَنْهُمْ سَمْعُهُمْ وَلَا أَبْصَارُهُمْ وَلَا  
أَفْئِدَتُهُمْ مِّنْ شَيْءٍ إِذْ كَانُوا يَجْحَدُونَ ۗ  
بِآيَاتِ اللَّهِ وَحَاقَ بِهِمْ مَا كَانُوا بِهِ  
يَسْتَهْزِئُونَ ﴿٢٧﴾

وَلَقَدْ أَهْلَكْنَا مَا حَوْلَكُمْ مِّنَ الْقُرَىٰ  
وَ صَرَّفْنَا الْآيَاتِ لَعَلَّهُمْ يَرْجِعُونَ ﴿٢٨﴾

فَلَوْلَا نَصْرَهُمُ الَّذِينَ اتَّخَذُوا مِنْ دُونِ  
اللَّهِ قُرْبَانًا إِلَهًا ۗ بَلْ صَلَّوْا عَنْهُمْ ۗ  
وَذَلِكَ أَفْكَهُمُ وَمَا كَانُوا يَفْتَرُونَ ﴿٢٩﴾

وَإِذْ صَرَفْنَا إِلَيْكَ نَفَرًا مِّنَ الْجِنِّ  
يَسْمِعُونَ الْقُرْآنَ ۗ فَلَمَّا حَصَرُوهُ قَالُوا  
أَنْصِتُوا ۗ فَلَمَّا قُضِيَ وَلَّوْا إِلَىٰ قَوْمِهِمْ  
مُنذِرِينَ ﴿٣٠﴾

3. Xhindët që janë përmendur në këtë ajet nuk do të thotë xhindë që përfliten në përgjithësi, por nënkuptojnë prijës të një populli të fuqishëm, të cilët kur e dëgjuan lajmin për Profetin Muhammed<sup>savs</sup>, vendosën ta vizitonin atë që të merrnin hapin e duhur. Andaj, kur u kthyen te populli i tyre, ua dhanë lajmin e mirë të vërtetësisë së Profetit Muhammed<sup>savs</sup>.

31. Thanë: “O populli ynë! Pa dyshim, kemi dëgjuar një Libër që u zbrit pas Musait, si vërtetues i asaj që qe përpara, udhëzon tek e vërteta dhe në rrugë të drejtë.<sup>4</sup>

قَالُوا يَقَوْمَنَا إِنَّا سَمِعْنَا كِتَابًا أُنزِلَ مِنْ  
بَعْدِ مُوسَى مُصَدِّقًا لِمَا بَيْنَ يَدَيْهِ يَهْدِي  
إِلَى الْحَقِّ وَالْإِلَهِيِّ ۝٣١

32. O populli ynë! Përgjigjuni thirrësit të Allahut dhe besoni në të; Ai do t’ju falë gjynahet dhe do t’ju shpëtojë nga ndëshkimi i dhimbshëm.

يَقَوْمَنَا أَجِيبُوا دَاعِيَ اللَّهِ وَآمِنُوا بِهِ  
يَغْفِرْ لَكُمْ مِنْ ذُنُوبِكُمْ وَيَجْرِمْ مَنْ  
عَذَابِ إِلِيهِ ۝٣٢

33. Dhe ai që nuk i përgjigjet thirrësit të Allahut, nuk mund ta mundë dot (Allahun) në tokë dhe as nuk do të ketë ndihmës të tjerë përveç Tij. Të tillët janë në devijim të qartë.<sup>5</sup>

وَ مَنْ لَا يُجِيبُ دَاعِيَ اللَّهِ فَلَيْسَ  
بِمُعْجِزٍ فِي الْأَرْضِ وَلَيْسَ لَهُ مِنْ دُونِهِ  
أَوْلِيَاءٌ ۝٣٣ أُولَئِكَ فِي ضَلَالٍ مُّبِينٍ ۝٣٣

34. A nuk menduan që Ai Allah që krijoi qiejt dhe tokën dhe (që) nuk u lodh nga krijimi i tyre, është i Fuqishëm të ringjallë të vdekurit?! Pse jo! Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë.<sup>6</sup>

أَوَلَمْ يَرَوْا أَنَّ اللَّهَ الَّذِي خَلَقَ السَّمَوَاتِ  
وَالْأَرْضِ وَلَمْ يَعْ يَخْلُقْهُنَّ بِقُدْرٍ عَلَى  
أَنْ يُحْيِيَ الْمَوْتَىٰ ۝٣٤ بَلَىٰ إِنَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ  
قَدِيرٌ ۝٣٤

35. Dhe ditën kur ata që mohuan do të sillen përpara zjarrit, (do t’u thuhet): “A nuk është e vërtetë kjo?!” Ata do të thonë: “Për Zotin tonë, pa dyshim që po!” Ai do t’u thotë:

وَيَوْمَ يُعْرَضُ الَّذِينَ كَفَرُوا عَلَى النَّارِ ۝٣٥  
أَلَيْسَ هَذَا بِالْحَقِّ ۝٣٥ قَالُوا بَلَىٰ وَرَبِّنَا ۝٣٥  
قَالَ فَذُوقُوا الْعَذَابَ بِمَا كُنْتُمْ

4. Ky ajet e sqaron shumë mirë që ata e kuptuan se ka ardhur Profeti, i cili do të vinte me një Sheriat të përsosur pas Hazret Musait<sup>as</sup>.

5. Pasi ia dhanë popullit të tyre lajmin e ardhjes së Profetit<sup>savs</sup>, i këshilluan të besonin në të, nëse donin të mirën e vet, dhe i paralajmëruan se ai që e mohon thirrësin e Allahut, nuk mund ta mundë dot atë. Pra, ajeti tregon se grupi i xhindëve i përmendur më sipër ishin njerëz, më konkretisht, hebrenj (besimtarë të Librit të Musait<sup>as</sup>), sepse folën për Kuranin si një “Libër që u zbrit pas Musait”.

6. Pas këshillimit të tyre, Zoti i Madhërishtëm tërheq vëmendjen tek e vërteta absolute, për të cilën çdo Profet ka predikuar popullin e tij, dhe ajo është besimi në jetën pas vdekjes, sepse pa këtë, besimi është i mangët.

“Atëherë shijoni ndëshkimin për shkak se mohoni!”

تَكْفُرُونَ ﴿٢٦﴾

36. Duro, siç duruan të Dërguarit vullnetfortë dhe mos u nxito në lidhje me ta. Ditën kur ata do ta shohin atë për të cilën janë paralajmëruar, do t'u duket sikur qëndruan (duke e pritur) jo më shumë se një orë të ditës. U përcoll mesazhi. Vallë, a shkatërrohet ndokush tjetër përveç popullit të pabindur?!

فَاصْبِرْ كَمَا صَبَرَ أُولُو الْعَزْمِ مِنَ الرُّسُلِ

وَلَا تَسْتَعْجِلْ لَهُمْ ۚ كَانَتْهُمْ يَوْمَ يَرُونَ

مَا يُوعَدُونَ ۚ لَمْ يَلْبَثُوا إِلَّا سَاعَةً مِّنْ

نَهَارٍ ۚ بَلَّغَ ۚ فَهَلْ يُهْلِكُ إِلَّا الْقَوْمَ

الَّذِينَ يَفْسُقُونَ ﴿٢٧﴾

## Surja 47 – Muhammed

Surja Muhammed është medinase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka tridhjetë e nëntë ajete.

Kjo sure edhe pse është e shkurtër për nga numri i ajeteve, në praktikë sjell një përmbledhje të të gjitha sureve të mëparshme, njësoj si Profeti Muhammed<sup>savs</sup> që është pasqyrim i të gjithë Profetëve të tjerë.

Ajeti nr. 19 i kësaj sureje pohon se janë shfaqur të gjitha shenjat e afrimit të *kiametit* të madh shpirtëror, për të cilin është dërguar Profeti Muhammed<sup>savs</sup>. Andaj, ata që do të reflektojnë në kohën kur do të ngrihet ky kiamet, çfarë vlere do të ketë reflektimi i tyre?!





1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Atyre që mohuan dhe penguan nga rruga e Allahut, Ai do t'ua zhvlerësojë veprat.

الَّذِينَ كَفَرُوا وَصَدُّوا عَنْ سَبِيلِ اللَّهِ  
أَصَلَّ أَعْمَالَهُمْ ②

3. Dhe atyre që besuan, bënë të mira dhe besuan në atë që iu zbrit Muhammedit, dhe pikërisht ai është i vërteti prej Zotit të tyre, (Zoti) do t'ua largojë të këqijat dhe do t'ua përmirësojë gjendjen.

وَالَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ وَآمَنُوا  
بِمَا نُزِّلَ عَلَى مُحَمَّدٍ وَهُوَ الْحَقُّ مِنْ  
رَبِّهِمْ ③ كَفَّرَ عَنْهُمْ سَيِّئَاتِهِمْ وَأَصْلَحَ  
بَالَهُمْ ④

4. Kështu është sepse ata që mohuan, ndoqën gënjeshtren, kurse ata që besuan, ndoqën të vërtetën, (të ardhur) prej Zotit të vet. Kështu Allahu u paraqet njerëzve shembujt e tyre.

ذَلِكَ بِأَنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا اتَّبَعُوا الْبَاطِلَ  
وَأَنَّ الَّذِينَ آمَنُوا اتَّبَعُوا الْحَقَّ مِنْ  
رَبِّهِمْ ⑤ كَذَلِكَ يَضْرِبُ اللَّهُ لِلنَّاسِ  
أَمْثَالَهُمْ ⑥

5. Kur të ndesheni me ata që mohuan, mëshojuni në qafë. Pasi t'i dërrmoni, lidhini fort. E më pas, lirojini në daç me mirësi, në daç me shpagim, derisa lufta të dorëzojë armët e saj. Kështu duhet. Dhe nëse do të donte Allahu, (Vetë) do të hakmerrej me ta, por (Ai deshi) që t'ju sprovojë ju përmes njëri-tjetrit. Dhe atyre që vriten në rrugën e Allahut, Ai kurrë nuk do t'ua zhvlerësojë veprat.<sup>1</sup>

فَإِذَا لَقِيتُمْ الَّذِينَ كَفَرُوا فَضَرْبَ  
الرِّقَابِ ⑦ حَتَّىٰ إِذَا أَخْنَمْتُمُوهُمْ فَشُدُّوا  
أَوْثَاقَهُمْ فِيمَا مَثًا بَعْدَ وَإِنَّمَا فَدَاءٌ حَتَّىٰ  
تَضَعَ الْحَرْبُ أَوْزَارَهَا ⑧ ذَلِكَ ⑨ وَلَوْ  
يَشَاءُ اللَّهُ لَانتَصَرَ مِنْهُمْ وَلَكِن لِّيَبْلُوَ  
بَعْضَكُمْ بَعْضًا ⑩ وَالَّذِينَ قَتَلُوا فِي سَبِيلِ  
اللَّهِ فَلَنْ يُضِلَّ أَعْمَالَهُمْ ⑪

1. Ky ajet tregon disa pika parimore të xhihadit me armë në rrugë të Allahut. Së pari, siç na tregojnë edhe ajete të tjera të Kuranit (p.sh. 22:40), Allahu i porositi muslimanët të luftojnë kundër atyre që e nisën luftën, derisa t'i mposhtin ata. Më pas, t'i mbajnë të lidhur fort, derisa të përfundojë lufta. Pas asaj, t'i lirojnë duke ua marrë shpagimin për demin që kanë shkaktuar,

6. Do t'i udhëzohë, do ta përmirësojë gjendjen e tyre;

سَيَهْدِيهِمْ وَيُصْلِحُ بَالَهُمْ ﴿٦﴾

7. dhe do t'i pranojë në xhenetin që Ai e përsosi për hir të tyre.

وَيُدْخِلُهُمُ الْجَنَّةَ عَرَفَهَا لَهُمْ ﴿٧﴾

8. O ju që besuat! Nëse e ndihmoni Allahu, Ai do t'ju ndihmojë ju dhe do t'ju forcojë këmbët.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِن تَنْصُرُوا اللَّهَ يَنْصُرْكُمْ وَيُثَبِّتْ أَقْدَامَكُمْ ﴿٨﴾

9. Kurse ata që mohuan, rënçin përmbys; dhe (Allahu) ua zhvlerësoi veprat.

وَالَّذِينَ كَفَرُوا فَتَحَسَّ لَهُمْ وَأَصَلَّ أَعْمَالَهُمْ ﴿٩﴾

10. Kështu ndodhi sepse ata e urryen atë që zbriti Allahu, andaj, Ai ua rrëzoi veprat.

ذَلِكَ بِأَنَّهُمْ كَرِهُوا مَا أَنْزَلَ اللَّهُ فَأَحْطَ أَعْمَالَهُمْ ﴿١٠﴾

11. A nuk kanë shëtitur në tokë, që të shihnin sesi ishte fundi i atyre që ishin para tyre?! Allahu i shkatërroi ata, të cilët janë (bërë) shembuj për mohuesit.

أَفَلَمْ يَسِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَيَنْظُرُوا كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ ۗ دَمَرَهُ اللَّهُ عَلَيْهِمْ ۗ وَلِلْكَافِرِينَ أَمَثَلُهُمْ ﴿١١﴾

12. Kështu ndodhi sepse Allahu është Miku i atyre që besuan dhe se mohuesit nuk kanë asnjë mik.

ذَلِكَ بِأَنَّ اللَّهَ مَوْلَى الَّذِينَ آمَنُوا وَأَنَّ الْكُفْرَانَ لَا مَوْلَى لَهُمْ ﴿١٢﴾

13. Ata që besuan dhe bënë të mira, Allahu do t'i shpjerë në xhenete, nën të cilat rrjedhin lumenj. Kurse ata që mohuan, përfitojnë përkohësisht, ushqehen siç ushqehen bagëtitë, ndërkohë zjarri është streha e tyre.

إِنَّ اللَّهَ يُدْخِلُ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ ۗ وَالَّذِينَ كَفَرُوا يَتَمَتَّعُونَ وَيَأْكُلُونَ كَمَا تَأْكُلُ الْأَنْعَامُ وَالنَّارُ مَثْوًى لَهُمْ ﴿١٣﴾

ose duke u bërë mirësi, dhe mirësia është më e pëlqyeshme. Disa njerëz akuzojnë fenë Islame, duke i quajtur luftërat e saj mbrojtëse si luftëra të dhunshme për konvertimin e njerëzve në muslimanë, ky ajet e hedh poshtë akuzën e tyre. A mund të ishte ndonjë moment tjetër më optimal për t'i konvertuar njerëzit me dhunë në muslimanë, sesa ai kur ata të jenë kapur dhe të jenë lidhur fort?! Por ky ajet jo vetëm që nuk e përmend fare konvertimin, por i porosit muslimanët të veprojnë për lirim të tyre pa marrë parasysh besimin, madje, t'i lirojnë duke u bërë mirësi, nëse ata nuk kanë mundësi ta japin shpagimin.

14. Sa shumë qytete kanë qenë që ishin më të forta se qyteti yt që të dëboi ty! Ne i shkatërruam, dhe ata nuk kanë pasur asnjë ndihmës.

15. Ai që qëndron mbi një shenjë të qartë prej Zotit të tij, a mund të jetë si ata të cilëve veprat e tyre të këqija iu dukën të bukura dhe që kanë ndjekur dëshirat vetjake?!

16. Shembulli i atij xheneti që u premtohet atyre që kanë drojë (ndaj Zotit), është (si kopshti) në të cilin ka lumenj me ujë që nuk ndotet, dhe lumenj me qumësht që nuk i ndryshon shija, dhe lumenj me verë që u jep kënaqësi atyre që pinë, dhe lumenj me mjaltë të kulluar. Ata do të kenë atje çdolloj frute, si dhe falje prej Zotit të tyre. (Këta) a mund të jenë si ata që jetojnë në zjarr për një kohë të gjatë, ku u jepet për të pirë ujë i valuar, që do t'ua pëlcasë zorrët?!<sup>2</sup>

وَكَانَ مِنْ قَرِيَةٍ هِيَ أَشَدُّ قُوَّةً مِنْ قَرِيَّتِكَ الَّتِي أَخْرَجْتِكَ ۚ أَهْلَكْنَاهُمْ فَلَا نَاصِرَ لَهُمْ ۝١٤

أَفَمَنْ كَانَ عَلَىٰ بَيِّنَةٍ مِنْ رَبِّهِ كَمَنْ زُرِّيٰ لَهُ سُوءٌ عَمَلِهِ وَاتَّبَعُوا أَهْوَاءَهُمْ ۝١٥

مَثَلُ الْجَنَّةِ الَّتِي وَعَدَ الْمُتَّقُونَ ۚ فِيهَا أَنْهَارٌ مِنْ مَاءٍ غَيْرِ آسِنٍ ۚ وَأَنْهَارٌ مِنْ لَبَنٍ لَمْ يَتَغَيَّرْ طَعْمُهُ ۚ وَأَنْهَارٌ مِنْ خَمْرٍ لَذَّةٍ لِلشَّرَابِ ۚ وَأَنْهَارٌ مِنْ عَسَلٍ مُصَفًّى ۚ وَلَهُمْ فِيهَا مِنْ كُلِّ الثَّمَرَاتِ وَمَغْفِرَةٌ مِنْ رَبِّهِمْ ۚ كَمَنْ هُوَ خَالِدٌ فِي النَّارِ وَسُقُوا مَاءً حَمِيمًا فَقَطَّعَ أَمْعَاءَهُمْ ۝١٦

2. Ky ajet paraqet një sërë konotacionesh, të cilat nuk duhet të merren në kuptimin e tyre të drejtpërdrejtë, sepse në botën lëndore as uji e as qumështi nuk mund të mbeten pa u prishur me kalimin e kohës; as vera nuk është e tillë që të jep vetëm kënaqësi dhe jo dehje. Përveç kësaj, në këtë botë nëse njeriut do t'i jepen vetëm këto gjëra që janë përmendur në këtë ajet, ai sërish nuk mbetet i kënaqur. Andaj, ky ajet pa dyshim ka një gjuhë të figurshme. Njerëzit që shohin dobi te këto gjëra ose përfitojnë prej tyre, po njoftohen që në xhenet ata do të gëzojnë bekimet më të mira dhe më të dobishme se këto. Me fjalë të tjera, ky ajet thotë se xhenetin kuptojeni me një shembull që aty ka lumenj të pakufishëm me këto gjëra. Pra, uji jetëdhënës që njohësi i Zotit e pi shpirtërisht në këtë botë, në botën tjetër do të jetë fizikisht; qumështi shpirtëror me të cilin ai rrit fuqinë shpirtërore në këtë botë, porsi fëmija që rritet me qumësht, në botën tjetër do të gjendet i dukshëm fizikisht; vera e dashurisë së Zotit që i jep dehje shpirtërore në këtë botë, në parajsë do të jetë në formë lumenjsh të dukshëm; dhe mjalti i ëmbëlsisë së besimit që në këtë botë njohësi i Zotit e shijon në mënyrë shpirtërore, në xhenet do të jetë i dukshëm dhe i bollshëm në formë lumenjsh. Çdo banor i xhenetit me lumenjtë dhe me kopshtet e tij do të tregojë drejtpërdrejt gjendjen e tij shpirtërore. Edhe Zoti atë ditë do të shfaqet për banorët e xhenetit. Kështu që, gjendet shpirtërore nuk do të jenë më të fshehta, por do të duken edhe fizikisht. Lexoni edhe 2:26; 32:18.

17. Dhe prej tyre ka nga ata, të cilët bëjnë (sikur) të dëgjojnë ty, por kur largohen prej teje, pyesin ata që kanë dije: “Çfarë tha ai qëparë?” Këta janë ata të cilëve Allahu ua ka vulosur zemrat dhe ata ndoqën dëshirat vetjake.

وَمِنْهُمْ مَّنْ يَسْتَمِعُ إِلَيْكَ ۚ حَتَّىٰ إِذَا خَرَجُوا  
مِنْ عِنْدِكَ قَالُوا لِلَّذِينَ أُوتُوا الْعِلْمَ مَاذَا  
قَالَ أَنفَاءُ ۚ أُولَٰئِكَ الَّذِينَ طَبَعَ اللَّهُ عَلَىٰ  
قُلُوبِهِمْ وَاتَّبَعُوا أَهْوَاءَهُمْ ﴿١٧﴾

18. Kurse ata që pranuan udhëzimin, Ai ua shtoi udhëzimin edhe më shumë dhe ua dha druajtjen.

وَالَّذِينَ اهْتَدَوْا زَادَهُمْ هُدًىٰ وَوَسَّعَتْ  
لَهُمْ سُبُلَهُمْ ﴿١٨﴾

19. A po presin vetëm Orën që t'u vijë befasi?! Atëherë u kanë ardhur tashmë shenjat e saj. E kur do t'u ketë ardhur edhe ajo, çfarë vlere do të ketë reflektimi i tyre?!

فَهَلْ يَنْظُرُونَ إِلَّا السَّاعَةَ أَنْ تَأْتِيَهُمْ  
بَغْتَةً ۚ فَتَدْجَأَ فَأَشْرَاطُهَا ۚ فَاَلَيْسَ لَهُمْ إِذَا  
جَاءَتْهُمْ ذِكْرُهُمْ ﴿١٩﴾

20. Andaj, dije që nuk ka të adhurueshëm tjetër përveç Allahut dhe kërko falje për gabimin tënd, për besimtarët dhe besimtare. Allahu jua di edhe vendin ku shkoni, edhe vendin ku qëndroni.

فَاعْلَمُوا أَنَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَاسْتَغْفِرُوا  
لِدُنْيِكُمْ ۖ وَالْمُؤْمِنِينَ وَالْمُؤْمِنَاتِ ۗ وَاللَّهُ  
يَعْلَمُ مَقَلِّبِكُمْ وَمَشَاكِمِكُمْ ﴿٢٠﴾

21. Dhe ata që besuan thonë: “Pse nuk zbriti ndonjë sure?” Kur do të zbritet një sure vendimtare, në të cilën të përmendet edhe lufta, do t'i shohësh ata që kanë “sëmundje” në zemër, se si të shikojnë ty me shikim të pushtuar nga vdekja.<sup>3</sup> U shkatërrofshin!

وَيَقُولُ الَّذِينَ آمَنُوا لَوْلَا نُزِّلَتْ سُورَةٌ ۚ  
فَإِذَا نُزِّلَتْ سُورَةٌ مُحْكَمَةٌ وَذُكِرَ فِيهَا  
النِّقَاتُ ۖ رَأَيْتَ الَّذِينَ فِي قُلُوبِهِمْ مَّرَضٌ  
يَنْظُرُونَ إِلَيْكَ نَظَرَ الْمَعْشِيِّ عَلَيْهِ مِنَ  
الْمَوْتِ ۗ فَأُولَٰئِكَ لَهُمْ ﴿٢١﴾

3. Besimtarët e vërtetë kaq shumë duan të praktikojnë udhëzimet e Zotit, saqë rrinë duke pritur që Zoti t'u japë ndonjë urdhër e ata ta zbatojnë atë. Kurse gjendja e hipokritëve është që ata sapo të dëgjojnë ndonjë urdhër të Zotit që flet për sakrificën, ata bëhen të tillë sikur t'i ketë pushtuar agonia e vdekjes.

22. Duhet bindje dhe fjalë e mirë! E tani që u vendos çështja, do të ishte mirë për ta nëse do të jenë të sinqertë ndaj Allahut.

23. Atëherë, a mundet që nëse bëheni drejtues, të bëni çrregullime në tokë dhe të këputni lidhjet tuaja farefisnore?! (Kurrsesi!)

24. Këta janë ata që i ka mallkuar Allahu, pra, i shurdhoi dhe ua verboi sytë.

25. A nuk thellohen në Kuran apo ka dryna në zemrat e tyre?!

26. Pa dyshim, ata që kthehen mbrapsht duke e lënë besimin, pasi u ishte bërë i qartë udhëzimi, djalli i joshi dhe u ka dhënë shpresa të rreme.

27. Kështu ndodhi sepse ata u thanë atyre që e urryen atë që zbriti Allahu: “Do t’ju bindemi juve në disa çështje”. Allahu ua di fshehtësitë.

28. E si do të jetë atëherë kur engjëjt do t’ua marrin shpirtin duke ua goditur fytyrat dhe shpinat?!

29. Kështu ndodh sepse ata ndoqën atë që zemëron Allahun, dhe se urryen pëlqimin e Tij, andaj, Ai ua zhvlerësoi veprat.

30. Ata që kanë “sëmundje” në zemër, a menduan se Allahu nuk do

طَاعَةً وَ قَوْلٍ مَّعْرُوفٍ ۚ فَإِذَا عَزَمَ  
الْأَمْرَ ۚ فَلَوْ صَدَقُوا اللَّهَ لَكَانَ خَيْرًا  
لَّهُمْ ۚ

فَهَلْ عَسَيْتُمْ إِنْ تَوَلَّيْتُمْ أَنْ تُفْسِدُوا فِي  
الْأَرْضِ وَتُقْطِعُوا أَرْحَامَكُمْ ۗ

أُولَئِكَ الَّذِينَ لَعَنَهُمُ اللَّهُ فَأَصَمَّهُمْ  
وَاعَلَىٰ أَبْصَارِهِمْ ۖ

أَفَلَا يَتَذَكَّرُونَ ۗ الْقُرْآنَ أَمْ عَلَىٰ قُلُوبٍ  
أَقْفَالٌهَا ۗ

إِنَّ الَّذِينَ ارْتَدُّوا عَلَىٰ أَدْبَارِهِمْ مِنْ بَعْدِ  
مَا تَبَيَّنَ لَهُمُ الْهُدَىٰ ۗ الشَّيْطَانُ سَوَّلَ  
لَهُمْ ۗ وَأَمَلَىٰ لَهُمْ ۗ

ذَٰلِكَ بِأَنَّهُمْ قَالُوا لِلَّذِينَ كَرِهُوا مَا نَزَّلَ  
اللَّهُ سَنُطِيعُكُمْ فِي بَعْضِ الْأَمْرِ ۗ وَاللَّهُ  
يَعْلَمُ إِسْرَارَهُمْ ۗ

فَكَيْفَ إِذَا تَوَفَّتْهُمُ الْمَلَائِكَةُ يَضْرِبُونَ  
وُجُوهَهُمْ وَآدْبَارَهُمْ ۗ

ذَٰلِكَ بِأَنَّهُمْ اتَّبَعُوا مَا أَصْحَبَ اللَّهَ  
وَكَرِهُوا رِضْوَانَهُ فَاحْبَطَ أَعْمَالَهُمْ ۗ

أَمْ حَسِبَ الَّذِينَ فِي قُلُوبِهِمْ مَرَضٌ أَنْ

t'ua nxjerrë në shesh mëritë e tyre të fshehta?!

لَنْ يُخْرِجَ اللَّهُ أَضْعَانَهُمْ ۝۳۰

31. Nëse duam, do t'i tregojmë ty dhe ti do t'i njohësh ata nga shenjat e tyre dhe do t'i njohësh nga mënyra e të shprehurit të tyre. Allahu jua di veprat.

وَلَوْ نَشَاءُ لَأَرَيْنَهُمْ فَلَعَرَفْتَهُمْ  
بِسِيمَتِهِمْ ۖ وَلَنَعْرِفَنَّهُمْ فِي لَحْنِ الْقَوْلِ  
وَاللَّهُ يَعْلَمُ أَعْمَالَكُمْ ۝۳۱

32. Ne patjetër do t'ju sprovojmë, derisa t'i dallojmë mes jush ata që luftojnë dhe durojnë. Dhe Ne do t'i shqyrtojmë gjendjet tuaja.

وَلَنَبْلُوَنَّكُمْ حَتَّى نَعْلَمَ الْمُجْهِدِينَ مِنْكُمْ  
وَالضَّعِيفِينَ ۖ وَنَبْلُوَنَّكُمْ ۝۳۲

33. Ata që mohuan, (që) penguan (të tjerët) nga rruga e Allahut dhe e kundërshtuan të Dërguarin pasi u ishte bërë i qartë udhëzimi, kurrsesi nuk mund ta dëmtojnë dot Allahun aspak. Ai me siguri do t'ua zhvlerësojë veprat.

إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا وَصَدُّوا عَنْ سَبِيلِ اللَّهِ  
وَشَاقُّوا الرَّسُولَ مِنْ بَعْدِ مَا تَبَيَّنَ لَهُمُ  
الْهُدَىٰ لَنْ يَضُرُّوا اللَّهَ شَيْئًا وَسَيُحِطُّ  
أَعْمَالَهُمْ ۝۳۳

34. O ju që besuat, bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe mos i zhvlerësoni veprat tuaja.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا أَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا  
الرَّسُولَ وَلَا تُبْطِلُوا أَعْمَالَكُمْ ۝۳۴

35. Ata që mohuan dhe penguan (të tjerët) nga rruga e Allahut, më pas vdiqën në gjendje mohimi, Allahu kurrë nuk do t'i falë.

إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا وَصَدُّوا عَنْ سَبِيلِ اللَّهِ  
ثُمَّ مَاتُوا وَهُمْ كُفَّارٌ فَلَنْ يَغْفِرَ اللَّهُ  
لَهُمْ ۝۳۵

36. Andaj, mos u ligështoni e të ftoni drejt pajtimit, ndërkohë ju do të jeni triumfues. Allahu është me ju dhe Ai kurrë nuk do t'ua ulë (vlerën) veprave tuaja.

فَلَا تَهِنُوا وَتَدْعُوا إِلَى السَّلْمِ ۗ وَأَنْتُمْ  
الْأَعْلَوْنَ ۗ وَاللَّهُ مَعَكُمْ وَلَنْ يَتْرُكَكُمْ  
أَعْمَالَكُمْ ۝۳۶

37. Sigurisht, jeta e kësaj bote është vetëm një lojë e argëtim. Por nëse besoni dhe keni druajtje (ndaj Zotit),

إِنَّمَا الْحَيَاةُ الدُّنْيَا لَعِبٌ وَ لَهْوٌ ۖ وَإِنْ  
تُؤْمِنُوا وَتَتَّقُوا يُؤْتِكُمْ أَجْرَكُمْ وَلَا

Ai do t'ju japë shpërblimet dhe nuk do t'ju kërkojë pasuritë tuaja.

يَسْأَلُكُمْ أَمْوَالَكُمْ ۗ

38. Ai po t'ju kërkonte pasuritë tuaja duke e tepruar, ju do të tregoheshit koprracë dhe Ai do t'jua nxirrte (në shesh) meritë tuaja.

إِنْ يَسْأَلْكُمْ مَّا فِي بُحُورِكُمْ تَبَحُلُوا  
وَيُخْرِجُ أَضْعَانَكُمْ ۗ

39. Ja pra, jeni ju që thirreni të shpenzoni në rrugën e Allahut. Po prej jush ka nga ata që tregohen koprracë; dhe ai që bëhet koprrac, koprracia e tij është kundër vetvetes së tij. Allahu është i Pasuri dhe jeni ju nevojtarët. Nëse do të ktheheni mbrapsht, Ai do t'ju zëvendësojë me një popull tjetër; më pas ata nuk do të jenë si ju.

هَآأَنْتُمْ هَؤُلَاءِ تُدْعُونَ لِيَتَنَفَّقُوا فِي سَبِيلِ  
اللَّهِ ۗ فَمِنْكُمْ مَّنْ يَبْخُلُ ۗ وَمَنْ يَبْخُلْ  
فَإِنَّمَا يَبْخُلْ عَن نَّفْسِهِ ۗ وَاللَّهُ الْغَنِيُّ  
وَأَنْتُمْ الْفُقَرَاءُ ۗ وَإِنْ تَوَلَّوْا يَسْتَبَدِلْ  
بِكُمْ قَوْمًا غَيْرَكُمْ ۗ ثُمَّ لَا يَكُونُوا أَمْثَالَكُمْ ۗ

## Surja 48 – El-Fet’h

Surja El-Fet’h zbriti pas kthimit nga Marrëveshja e Hudejbijes dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka tridhjetë ajete.

Kjo sure që vjen pas sures Muhammed, në ajetin nr. 11 të saj tregon pozitën shumë të lartë të Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, duke zbuluar se ai ishte bërë tërësisht i Allahut të Madhërishëm, andaj, ardhja e tij me fjalë të tjera ishte manifestim i Allahut, betimi (*bejati*) në dorën e tij u cilësua si betim në dorën e Allahut:

*“Sigurisht, ata që të betohen ty, në të vërtetë i betohen Allahut; Dora e Allahut është mbi duart e tyre.”*

Në ajetin nr. 19, Allahu i Madhërishëm e përsëriti edhe një herë temën e *bejatis* (e betimit), duke iu referuar ngjarjes së Hudejbijes, ku nën një pemë, muslimanët ribënë *bejatin* e tyre të besnikërisë me Profetin Muhammed<sup>savs</sup>. Menjëherë pas kësaj, Allahu i Madhërishëm dha premtimin e Tij që sahabët<sup>ra</sup> do të gëzonin qetësi të madhe, pas brengës së tyre të shkaktuar nga mosrealizimi i Haxhit, kurse moshyrjen në Mekë të tyre që po konsiderohej si humbje, e quajti gurthemel të shumë fitoreve të ardhshme, jo vetëm në të ardhmen e shpejtë, por edhe në atë të mëvonshme.

Në ajetet e fundit të kësaj sureje, Allahu i Madhërishëm u premtonte besimtarëve që ëndrra që Ai ia dërgoi Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, do të përmbushet patjetër dhe se sahabët<sup>ra</sup> do të bëhen dëshmitarë të këtij fakti, sepse do të hyjnë në Mekë duke kryer ritualet e Haxhit, dhe kjo fitore në Mekë, do t’u paraprijë shumë fitoreve të tjera anekënd botës.

Pas sures Muhammed, edhe kjo sure e përmend emrin e bekuar të Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, duke iu referuar edhe profecisë së Hazret Musait<sup>as</sup>, në të cilën ardhja e tij ishte përmendur me emrin konkret të Muhammedit, po kështu ishin përmendur të gjitha cilësitë që pasqyronin *madhështinë* e tij, të cilën do ta zotëronin ai dhe sahabët e tij. Po në vijim, i njëjti ajet përmend një profeci tjetër edhe nga Inxhili. Pra, profecia për ardhjen e Profetit Muhammed<sup>savs</sup> është përmendur jo vetëm në Dhiatën e Vjetër, por edhe në Dhiatën e Re nga goja e Hazret Isait<sup>as</sup>, i cili është një pasqyrim i *hijeshisë* së Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, dhe që jep shembullin e këtij Profeti me një arë, të cilën mendjemadhi nuk do të arrijë ta shkatërrojë, pavarësisht nga keqdashjet. Përveç kësaj, fjala “bujk” është përmendur në shumës (arab. *ez-zurra*), gjë që tregon se do të jenë disa bujq që do ta mbjellin këtë arë.





1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Pa dyshim, Ne të dhamë ty një fitore të qartë.

إِنَّا فَتَحْنَا لَكَ فَتْحًا مُّبِينًا ①

3. Që të të falë Allahu çdo gabim tëndin të mëparshëm dhe të ardhshëm, ta plotësojë bekimin e Tij mbi ty dhe të të udhëzojë në rrugë të drejtë.<sup>1</sup>

لِيُغْفِرَ لَكَ اللَّهُ مَا تَقَدَّمَ مِنْ ذَنْبِكَ وَمَا تَأَخَّرَ وَيَتَمَّ نِعْمَتَهُ عَلَيْكَ وَيَهْدِيكَ صِرَاطًا مُسْتَقِيمًا ①

4. Dhe që të të ndihmojë Allahu me ndihmë të fuqishme.

وَيُضْرِكَ اللَّهُ نَصْرًا عَزِيزًا ①

5. Është Ai që zbriti qetësinë në zemrat e besimtarëve, që ata, me besimin e tyre (që kanë), të përparojnë edhe më shumë në besim. Të Allahut janë ushtritë e qiejve dhe të tokës. Allahu është i Gjithëdijshëm, i Urtë.

هُوَ الَّذِي أَنْزَلَ السَّكِينَةَ فِي قُلُوبِ الْمُؤْمِنِينَ لِيَرُدَّادُوا إِيمَانًا مَعَ إِيمَانِهِمْ ①  
 وَلِلَّهِ جُنُودُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ① وَكَانَ اللَّهُ عَلِيمًا حَكِيمًا ①

1. Nëse i lexojmë me vëmendje të gjitha ajetet ku është përmendur *istigfari* duke iu referuar Profetit<sup>savs</sup> (40:56; 47:20; 48:2; 110:4), çdo herë në kontekst është përmendur fitorja e muslimanëve dhe humbja e mohuesve. Kjo pa dyshim e tregon se Zoti i kërkon Profetit të kërkojë falje për ata muslimanë, të cilët mund të gabonin në kohë fitoresh, sepse si Profet i tyre, ai kishte përgjegjësinë edhe të kujdesej për gjendjen e tyre shpirtërore. Përveç kësaj, sipas Kuranit të Shenjtë, *istigfari* ka edhe kuptimin e kërkimit të mbrojtjes së Zotit që Ai të na mbulojë dobësitë. Për shembull, në një ajet duke përmendur besimtarët e xhenetit, Allahu thotë: ata do t'i kërkojnë falje Zotit që Ai t'ua plotësojë dritën e tyre (66:9). Dihet që robi hyn në xhenet pasi t'i lahen gjynahet. Andaj, *istigfari* në këtë kontekst nënkupton që ata do t'i kërkojnë forcë Zotit për përparime të mëtejshme. Po kështu, në disa ajete Zoti i përshkruan besimtarët që ata kërkojnë falje gjatë agimit (51:19; 3:18), gjë që përveç kuptimit të kërkimfaljes për gabimet e bëra gjatë ditëve të mëparshme, ka edhe kuptimin që besimtarët i kërkojnë forcë Zotit për ditën që kanë përpara. Edhe këto ajete tregojnë që Zoti na urdhëron t'i kërkojmë falje jo vetëm nëse bëjmë ndonjë gjynah, por edhe pa u përfshirë në gjynah, sepse nëpërmjet kësaj metode, ne fitojmë forcë prej Zotit.

6. Që Ai t'i shpjerë besimtarët e besimtare të xhenete nëpër të cilat rrjedhin lumenj – ata në to do të jetojnë përgjithmonë –, dhe që t'u largojë mëkatet e tyre. Kjo tek Allahu është një sukses madhor.

7. Dhe që t'i ndëshkojë hipokritët e hipokritet, idhujtarët e idhujtare, paragjykesit ndaj Allahut me mendim të keq. Atyre do t'u bien fatkeqësitë e kohës. Allahu u zemërua mbi ta, i mallkoi dhe u përgatiti xhehenemin. Sa strehë e keqe është ai!

8. Të Allahut janë ushtritë e qiejve dhe të tokës. Allahu është Mbizotërues, i Urtë.

9. Sigurisht, Ne të dërguam si dëshmitar, sihariqdhënës dhe alarmues.

10. Që ju ta besoni Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ta ndihmoni dhe ta nderoni atë; dhe ta lartësoni Atë mëngjes e mbrëmje.

11. Ata që të betohen ty, në të vërtetë i betohen Allahut. Dora e Allahut është mbi duart e tyre. Ai që thyen betimin, e thyen kundër vetes së vet, dhe atij që e plotëson premtimin që ia bëri Allahut, Ai patjetër do t'i japë një shpërblim madhor.

12. Prej beduinëve, ata që mbetën mbrapa, do të të thonë patjetër: “Pasuritë tona dhe familjet tona na

لِيَدْخُلَ الْمُؤْمِنِينَ وَالْمُؤْمِنَاتِ جَنَّاتٍ  
تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا  
وَيُكَفَّرُ عَنْهُمْ سَيِّئَاتِهِمْ ۗ وَكَانَ ذَلِكَ عِنْدَ  
اللَّهِ قُوْرًا عَظِيْمًا ۝١

وَيُعَذِّبُ الْمُنَافِقِينَ وَالْمُنَافِقَاتِ وَالْمُشْرِكِينَ  
وَالْمُشْرِكَاتِ الظَّالِمِينَ بِاللَّهِ ظَنَّ السَّوْءِ ۗ  
عَلَيْهِمْ دَآبِرَةُ السَّوْءِ ۗ وَغَضِبَ اللَّهُ  
عَلَيْهِمْ وَلَعَنَهُمْ وَأَعَدَّ لَهُمْ جَهَنَّمَ ۗ  
وَسَاءَتْ مَصِيْرًا ۝٢

وَاللَّهُ جُوْدٌ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ۗ وَكَانَ  
اللَّهُ عَزِيْرًا حَكِيْمًا ۝٣

إِنَّا أَرْسَلْنَاكَ شَٰهِدًا وَوَمُبَشِّرًا وَنَذِيْرًا ۝٤

لِتُؤْمِنُوا بِاللَّهِ وَرَسُوْلِهِ وَتُعَزِّرُوْهُ  
وَتُوْقِرُوْهُ ۗ وَسِيْحُوْهُ بَكْرَةً وَأَصِيْلًا ۝٥

إِنَّ الَّذِينَ يُبَايِعُونَكَ إِنَّمَا يُبَايِعُونَ اللَّهَ ۗ  
يَدُ اللَّهِ فَوْقَ أَيْدِيهِمْ ۗ فَمَنْ نَكَثَ فَإِنَّمَا  
يَنْكُثُ عَلَى نَفْسِهِ ۗ وَمَنْ أَوْفَى بِمَا عٰهَدَ  
عَلَيْهِ اللَّهُ فَسَيُؤْتِيْهِ أَجْرًا عَظِيْمًا ۝٦

سَيَقُوْلُ لَكَ الْمُخَلَّفُونَ مِنَ الْأَعْرَابِ  
شَغَلْنَا أَمْوَالَنَا وَأَهْلُوْنَا فَاسْتَعْفِرْنَا ۗ

mbajtën të angazhuar (dhe nuk kemi marrë dot pjesë në këtë udhëtim), andaj, kërko falje për ne”. Ata thonë me gojë të tyre diçka që nuk e kanë në zemra. Pyeti: “Nëse Allahu dëshiron t’ju dëmtojë ose dëshiron t’ju sjellë dobi, kush ka fuqi ndopak përballë Tij?! Përkundrazi. Allahu është i Gjithinformuar për gjithçka që bëni.<sup>2</sup>

13. Madje, ju menduat që i Dërguari dhe besimtarët nuk do të kthehen kurrë më në familjet e tyre, dhe këtë e pëlqyen zemrat tuaja, ushqyet mendimin e keq dhe u bëtë popull i shkatërruar.”

14. Ai që nuk besoi në Allah dhe në të Dërguarin e Tij, (le ta dijë se) Ne me të vërtetë kemi përgatitur për mohuesit një zjarr flakërues.

15. I Allahut është sundimi i qiejve dhe i tokës. Ai fal kë të dojë dhe ndëshkon kë të dojë. Dhe Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

يَقُولُونَ بِأَلْسِنَتِهِمْ مَا لَيْسَ فِي قُلُوبِهِمْ ۗ  
قُلْ فَمَنْ يَمْلِكُ لَكُمْ مِنَ اللَّهِ شَيْئًا إِنْ  
أَرَادَ بِكُمْ ضَرًّا أَوْ أَرَادَ بِكُمْ نَفْعًا ۗ  
بَلْ كَانَ اللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرًا ﴿١٥﴾

بَلْ ظَنَنْتُمْ أَنْ نَخْلَقَ الرُّسُلَ  
وَالْمُؤْمِنُونَ إِلَىٰ أَهْلِيهِمْ أَبَدًا وَرُزِينَ  
ذَلِكَ فِي قُلُوبِكُمْ وَظَنَنْتُمْ ظَنًّا سَوْءًا  
وَكُنْتُمْ قَوْمًا بُورًا ﴿١٥﴾

وَمَنْ لَّمْ يُؤْمِنْ بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ فَإِنَّا  
أَعْتَدْنَا لِلْكَافِرِينَ سَعِيرًا ﴿١٥﴾

وَاللَّهُ مُلْكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ۗ يَعْرِفُ  
لِمَنْ يَشَاءُ وَيُعَذِّبُ مَنْ يَشَاءُ ۗ وَكَانَ اللَّهُ  
عَفُورًا رَحِيمًا ﴿١٥﴾

2. Ajeti u referohet disa fiseve beduine që jetonin përreth Medinës, dhe që kishin marrëdhënie miqësore me muslimanët. Këto fise u ftuan gjithashtu të bashkoheshin me grupin prej 1500 muslimanëve, të cilët do të shkonin në Mekë për të kryer Umranë. Megjithëse Profeti<sup>saws</sup> po shkonte në një mision paqeje, këto fise të shkretëtirës menduan se Kurejshët e Mekës nuk do të lejonin hyrjen e muslimanëve në Mekë dhe se sipas të gjitha gjasave do të kishte një përplasje armësh, dhe muslimanët që nuk ishin të armatosur siç duhej, do të mposhteshin. Për këtë arsye, ata shikonin që udhëtimi i Profetit të Shenjtë dhe i muslimanëve në drejtim të Mekës nuk ishte gjë tjetër, veçse marshimi drejt vdekjes. (Ibni Hishami; Ibni Kethiri). Në të njëjtën mënyrë, ajeti mund të aplikohet edhe për fiset që kishin mbetur mbrapa në Luftën e Tebukut, pasi, në suren Et-Teube, janë përdorur fjalë të ngjashme për to.

16. Kur të shkoni për të marrë plaçkat e luftës,<sup>3</sup> ata që mbetën mbrapa patjetër do t'ju thonë: “Na lejoni edhe ne t'ju ndjekim”. Dëshirojnë të ndërrojnë fjalën e Allahut. Thuaj: “Ju kurrësi nuk do të na ndiqni.” Kështu e ka thënë Allahu që më përpara. Atëherë ata do të thonë: “Jo, ju na keni zili!” Jo, në të vërtetë, ata kuptojnë shumë pak.

17. Thuaju beduinëve që mbetën mbrapa: “Së shpejti do të thirreni përpara një populli tepër luftarak; ju do të luftoni me ta, ose ata do të bëhen muslimanë. Kështu, nëse bindeni, Allahu do t'ju japë shpërblim të mirë, dhe nëse ktheheni duke e treguar shpinën, siç jeni kthyer më parë, do t'ju ju japë ndëshkim të dhimbshëm.”<sup>4</sup>

18. Nuk ka shtrëngim për të verbrin, nuk ka shtrëngim për të çalin dhe nuk ka shtrëngim as për të sëmurin

سَيَقُولُ الْمُخَلَّفُونَ إِذَا انطَلَقْتُمْ إِلَى مَعَانِمَ  
تَاتُخَذُوهَا ذُرُوءًا نَتَّبِعُكُمْ ۚ يُرِيدُونَ أَنْ  
يُبَدِّلُوا كَلِمَةَ اللَّهِ ۗ قُلْ لَنْ نَتَّبِعُونَ كَذِبَكُمْ  
قَالَ اللَّهُ مِنْ قَبْلِ ۚ فَسَيَقُولُونَ بَلْ  
نَحْسَدُؤُنَا ۗ بَلْ كَانُوا لَا يَفْقَهُونَ إِلَّا  
قَلِيلًا ﴿١٦﴾

قُلْ لِلْمُخَلَّفِينَ مِنَ الْأَعْرَابِ سُدْعُونَ  
إِلَى قَوْمِ أُولَىٰ بِأْسٍ شَدِيدٍ تَقَاتَلُوهُمْ  
أَوْ يَسْلَمُونَ ۚ فإِنْ تَطِيعُوا يُؤْتِكُمُ اللَّهُ  
أَجْرًا حَسَنًا ۚ وَإِنْ تَوَلَّوْا كَمَا تَوَلَّيْتُمْ مِنْ  
قَبْلِ يُعَذِّبْكُمْ عَذَابًا أَلِيمًا ﴿١٧﴾

لَيْسَ عَلَى الْأَعْمَىٰ حَرَجٌ وَلَا عَلَى  
الْأَعْرَجِ حَرَجٌ وَلَا عَلَى الْمَرِيضِ حَرَجٌ

3. Bëhet fjalë për plaçkat e luftës së Tebukut ose të Khajberit.

4. Ky ajet duket se parashikon luftërat që do të bëheshin me Mbretërinë Perse dhe Mbretërinë Bizantine. Zoti u tha hipokritëve që nëse do të tregoheshin të guximshëm gjatë atyre betejave, atyre do t'u faleshin mëkatet, përndryshe, do të kishin ndëshkimin e Zotit. Gjatë kohës së Kalifatit të *Hazret Omeri*<sup>ra</sup>, disa djem që ishin bij të prijësve arabë, shkuan tek *Hazret Omeri*<sup>ra</sup> dhe i kërkuan ndonjë metodë sesi ta zhdëmtonin imazhin e keq të baballarëve të tyre. *Hazret Omeri*<sup>ra</sup> u përlot dhe pa arritur të shprehte diçka me gojë, me dorë u bëri shenjë në drejtim të Shamit, duke i lënë të kuptonin që të shkonin atje në fushëbetejë për ta shpëguar dëmin. Historia dëshmon që të gjithë këta djem u nisën për në Sham për t'u bashkuar në radhët e ushtarëve muslimanë dhe asnjëri prej tyre nuk u kthye i gjallë. Të gjithë ranë dëshmorë në betejë. Ndoshta *Hazret Omeri*<sup>ra</sup> i udhëzoi në dritën e pikërisht këtij ajeti. Ky ajet gjithashtu tregon se ato luftëra do të zgjateshin shumë. Fjalët “ose ata do të bëhen muslimanë” nuk nënkuptojnë që muslimanët duhet të luftonin kundër tyre derisa ata të bëheshin muslimanë, pasi fjalia nuk është në mënyrën urdhërore, por është në kohën e ardhshme si profeci. Kuptimi është se kundërshtarët do ta vijonin luftën, derisa do të dorëzoheshin ose do të bëheshin muslimanë. Pikërisht kështu ngjau me të dyja mbretëritë.

(nëse ata nuk dalin në luftë). Ai që i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, (Allahu) do ta shpjerë atë në xhenete nëpër të cilat rrjedhin lumenj; kurse ai që e kthen shpinën, atij do t'i japë ndëshkim të dhimbshëm.

19. Pa dyshim, Allahu i pëlqeu besimtarët, kur ata po të betoheshin ty nën pemë.<sup>5</sup> Ai e di çfarë ka në zemrat e tyre, andaj ua zbriti qetësinë dhe u dhuroi një fitore të afërt;<sup>6</sup>

20. edhe plaçkat e luftës me shumicë, që ata do t'i merrnin. Allahu është Mbizotërues, i Urtë.

21. Allahu ju premtoi për plaçkat e luftës me shumicë që do t'i merrni, dhe këtë Ai jua shpejtoi,<sup>7</sup> dhe i ndaloi duart e njerëzve kundër jush,<sup>8</sup> që të jetë shenjë për besimtarët dhe t'ju udhëzojë në rrugë të drejtë.

22. Gjithashtu, ka edhe (fitore) të tjera që ju ende nuk i zotëroni, të cilat Allahu i ka rrethuar (për ju). Allahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë.<sup>9</sup>

وَمَنْ يُطِيعِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ يُدْخِلْهُ جَنَّاتٍ  
تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ وَمَنْ يَتَوَلَّ  
الْمُكْفِرِينَ يَعَذِّبْهُ عَذَابًا أَلِيمًا ۝

لَقَدْ رَضِيَ اللَّهُ عَنِ الْمُؤْمِنِينَ إِذْ  
يُبَايِعُونَكَ تَحْتَ الشَّجَرَةِ فَعَلِمَ مَا فِي  
قُلُوبِهِمْ فَأَنْزَلَ السَّكِينَةَ عَلَيْهِمْ وَأَثَابَهُمْ  
فَتْحًا قَرِيبًا ۝

وَ مَغَانِمَ كَثِيرَةً يَأْخُذُونَهَا وَكَانَ اللَّهُ  
عَزِيزًا حَكِيمًا ۝

وَعَدَّكُمْ اللَّهُ مَغَانِمَ كَثِيرَةً تَأْخُذُونَهَا  
فَعَجَلْ لَكُمْ هَذِهِ وَكَفَّ أَيْدِيَ النَّاسِ  
عَنْكُمْ ۚ وَلِتَكُونَ آيَةً لِّلْمُؤْمِنِينَ  
وَيَهْدِيَكُمْ صِرَاطًا مُسْتَقِيمًا ۝

وَ أُخْرَى لَمْ تَقْدِرُوا عَلَيْهَا قَدْ أَحَاطَ اللَّهُ  
بِهَا وَكَانَ اللَّهُ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرًا ۝

5. Kjo besëlidhje u bë në Hudejbije, ku sahabët<sup>ra</sup> u betuan për vdekje, duke vënë dorën mbi dorën e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>.

6. Dmth. fitore në Betejën e Khajberit.

7. Plaçkat e Betejës së Khajberit.

8. Gjatë Hudejbijes, kur mekasit nuk guxuan dot t'i sulmonin muslimanët.

9. Ajeti përmban profecinë se muslimanët do të arrijnë fitore të tjera shumë të mëdha pas fitores së Khajberit.

23. Dhe ata që mohuan, nëse luftojnë me ju, patjetër do të marrin arratinë, më pas nuk do të gjejnë as mik e as ndihmës.

24. Kjo është praktika e Allahut që ishte edhe më parë. Dhe ti nuk do të gjesh kurrsesi ndryshim në praktikën e Allahut.

25. Pikërisht është Ai që i ndaloi duart e tyre ndaj jush, si dhe duart tuaja ndaj tyre brenda Mekës, pasi ju dha juve fitoren mbi ta. Dhe Allahu është Gjithëshikuesi i asaj që bëni.

26. Pikërisht këta janë që mohuan dhe ju penguan nga Xhamia e shenjtë ju, si dhe kurbanet që ishin të dedikuara, duke mos i lejuar të arrinin te vendi i tyre. Dhe po të mos ishin disa burra besimtarë e disa gra besimtare që ju nuk i njihnit, dhe (po të mos ishte rreziku) që ju do t'i nëpërkëmbnit pa i njohur, (ose) do të dëmtoheshit prej tyre, (atëherë Ne do t'ju lejonim të luftonit). (Pra, përplasja nuk ndodhi) që Allahu të pranojë kë të dojë në mëshirën e Tij. (Besimtarët) po të ishin veçuar, Ne patjetër do t'i ndëshkonim ata që mohuan me ndëshkim të dhimbshëm.

27. Ata që mohuan, kur e vunë sedrën në zemrat e tyre, sedër injorance, Allahu zbriti qetësinë e Tij mbi të Dërguarin e Tij e mbi besimtarët, i mbajti të lidhur me fjalën e druajtjes

وَلَوْ فَتَلَكُمُ الَّذِينَ كَفَرُوا لَكُلُوا الْأَذْيَارَ  
ثُمَّ لَا يَجِدُونَ وِلِيًّا وَلَا نَصِيرًا ﴿٢٣﴾

سُنَّةَ اللَّهِ الَّتِي قَدْ خَلَتْ مِنْ قَبْلُ ۗ وَلَنْ  
تَجِدَ لِسُنَّةِ اللَّهِ تَبْدِيلًا ﴿٢٤﴾

وَهُوَ الَّذِي كَفَّ أَيْدِيَهُمْ عَنْكُمْ  
وَأَيْدِيَكُمْ عَنْهُمْ بِبَطْنِ مَكَّةَ مِنْ بَعْدِ  
أَنْ أَظْفَرَكُمْ عَلَيْهِمْ ۗ وَكَانَ اللَّهُ بِمَا  
تَعْمَلُونَ بَصِيرًا ﴿٢٥﴾

هُمُ الَّذِينَ كَفَرُوا وَصَدُّوكُمْ عَنِ الْمَسْجِدِ  
الْحَرَامِ وَالْأَهْدَىٰ مَعْرُوفًا أَنْ يَبْلُغَ مَجَلَّهُ ۗ  
وَلَوْلَا رِجَالٌ مُؤْمِنُونَ وَنِسَاءٌ مُؤْمِنَاتٌ  
لَّمْ تَعْلَمُوهُمْ أَنْ تَطَّوَّهُمْ فِتْصِيْبِكُمْ مِنْهُمْ  
مَعْرَةٌ بِيَعْرِ عِلْمٍ لِيَدْخِلَ اللَّهُ فِي  
رَحْمَتِهِ مَنْ يَشَاءُ ۗ لَوْ تَرَىٰ لَوْ تَرَىٰ لَوْ لَعَدَبْنَا  
الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْهُمْ عَذَابًا أَلِيمًا ﴿٢٦﴾

إِذْ جَعَلَ الَّذِينَ كَفَرُوا فِي قُلُوبِهِمُ الْحَمِيَّةَ  
الْحَمِيَّةَ الْجَاهِلِيَّةَ فَأَنْزَلَ اللَّهُ سَكِينَتَهُ  
عَلَىٰ رَسُولِهِ وَعَلَى الْمُؤْمِنِينَ وَأَلْزَمَهُمْ

(ndaj Allahut), dhe pikërisht ata ishin më të denjë dhe më të zotë të saj. Allahu është i Gjithëdijshëm për çdo gjë.

28. Pa dyshim, Allahu ia plotësoi të Dërguarit të Tij ëndrrën me vërtetësi: ju patjetër do të hyni në Xhaminë e shenjtë, në dashtë Allahu, të sigurt, do të rruani kokat tuaja dhe do të qetheni, pa frikë. Pra, Ai e di atë që ju nuk e dini. Përveç kësaj, Ai caktoi (për ju) një fitore të afërt.<sup>10</sup>

29. Është Ai që dërgoi të Dërguarin e Tij me udhëzimin dhe fenë e vërtetë, që ta bëjë atë të triumfojë mbi të gjitha fetë. Allahu është i mjaftueshëm si Dëshmitar.<sup>11</sup>

30. Muhammedi, i Dërguari i Allahut, si dhe ata që janë me të, janë të ashpër ndaj mohuesve (dhe) të mëshirshëm për njëri-tjetrin. Ti i sheh ata duke bërë ruku, sexhde,

كَلِمَةَ التَّقْوَىٰ وَكَانُوا أَحَقَّ بِهَا وَأَهْلَهَا ۗ  
وَكَانَ اللَّهُ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمًا ۝٧

لَقَدْ صَدَقَ اللَّهُ رَسُولَهُ الرُّءْيَا بِالْحَقِّ ۗ  
لَتَدْخُلَنَّ الْمَسْجِدَ الْحَرَامَ إِنْ شَاءَ اللَّهُ  
أَمِينِينَ ۗ مَحَلِّقِينَ رُءُوسَكُمْ وَمَقَصِّرِينَ  
لَا تَخَافُونَ ۗ فَعَلِمَ مَا لَمْ تَعْلَمُوا فَجَعَلَ مِنْ  
دُونِ ذَلِكَ فَتْحًا قَرِيبًا ۝٨

هُوَ الَّذِي أَرْسَلَ رَسُولَهُ بِالْهُدَىٰ وَدِينِ  
الْحَقِّ لِيُظْهِرَهُ عَلَى الدِّينِ كُلِّهِ ۗ وَكَفَىٰ بِاللَّهِ  
شَهِيدًا ۝٩

مُحَمَّدٌ رَسُولُ اللَّهِ ۗ وَالَّذِينَ مَعَهُ أَشِدَّاءُ  
عَلَى الْكُفَّارِ رُحَمَاءُ بَيْنَهُمْ تَرَاهُمْ رُكَّعًا  
سُجَّدًا يَبْتَغُونَ فَضْلًا مِنَ اللَّهِ وَرِضْوَانًا  
سِيَاهُمْ فِي وُجُوهِهِمْ مِنْ أَثَرِ السُّجُودِ ۗ

10. Ajeti i referohet ëndrrës që Profeti i Shenjtë<sup>savs</sup> e kishte parë se ai po kryente *tavafin* e Qabes me shokët e tij. Ai u nis për në Mekë me rreth 1500 shokë të tij për të kryer Umranë. Kurejshët nuk i lejuan të hynin në Qabe, megjithëse surja ishte e qartë dhe e theksuar se vizioni i Profetit ishte i vërtetë dhe se muslimanët me siguri do të hynin në Qabe dhe do ta kryenin Umranë. Por kur muslimanët nuk arritën ta realizonin ëndrrën dhe u detyruan të bënin Marrëveshjen e Hudejbijes, disa sahabë u mërztën. Profeti<sup>savs</sup> i qetësoi duke thënë se Zoti nuk i kishte thënë atij se vizita në Qabe do të bëhej pikërisht atë vit. Kështu që, ëndrra e tij u realizua vetëm një vit më vonë, në përputhje me kushtet e vendosura në Marrëveshjen e Hudejbijes. Udhëtimi i Profetit të Shenjtë, përveçse shërbeu për të vendosur themelet e disa fitoreve shumë të mëdha, për të cilat u tha në ajetet më lart, krijoi një precedent që tregoi se ndonjëherë edhe Profetët e mëdhenj të Zotit mund të mos interpretojnë saktë profecitë që u jep Zoti, dhe se dija e vërtetë u vjen vetëm prej Zotit.

11. Në këtë ajet, Allahu i Madhërishtëm bëri profecinë se Islami do të triumfojë mbi të gjitha fetë. Gjatë kohës së zbritjes së këtij ajeti, muslimanët ende nuk kishin gëzuar fitore as mbi mekasit. Andaj, në një kohë të tillë, profecia që Islami do të triumfojë mbi të gjitha fetë, është madhështore.

duke kërkuar prej Allahut bekim e pëlqim; kanë shenja në fytyrat e tyre nga gjurmët e sexhdeve. Ky është shembulli i tyre në Teurat. Dhe shembulli i tyre në Inxhil është ai i një are, që nxjerr filizin e saj, e forcon, gjersa ai bëhet i trashë dhe qëndron në kërcellin e vet; i gëzon bujqit që përmes tyre t'i zemërojnë mohuesit. Prej këtyre (njerëzve), atyre që besuan dhe bënë të mira, Allahu u premtoi falje e shpërblim madhor.<sup>12</sup>

ذٰلِكَ مَثَلُهُمْ فِي التَّوْرَةِ ۗ وَمَثَلُهُمْ فِي الْاِنْجِيلِ ۗ كَزَرْعٍ اَخْرَجَ شَطْءَهُ فَاَزْرَهُ فَاسْتَعْلَظَ فَاَسْتَوَىٰ عَلٰى سُوْقِهِ يُعْجِبُ الزَّرَّاعَ لِيَغِيْظَ بِهٖمُ الْكٰفِرٰٓطُ وَعَدَّ اللّٰهُ الَّذِيْنَ اٰمَنُوْا وَعَمِلُوا الصّٰلِحٰتِ مِنْهُمْ مَّغْفِرَةً وَّاَجْرًا عَظِيْمًا ۝۱۲

مَعَالِمٌ ۱۲

12. Cilësitë që janë përmendur në këtë ajet, nuk janë quajtur vetëm të Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, madje, menjëherë, pas fjalëve “Muhammedi, i Dërguari i Allahut”, tha “dhe ata që janë bashkë me të”, gjë që do të thotë se këto cilësi të tij do t'i trashëgojnë edhe ndjekësit e tij të sinqertë. Cilësia e parë është “të ashpër ndaj mohuesve”, gjë që nuk do të thotë se ata janë zemërgurë e të egër ndaj tyre, por do të thotë se janë të fortë për të mos pranuar asnjë ndikim të mohimit të tyre, pasi ata do të jenë shumë zemërbutë në natyrë, gjë që e vërteton mëshira e tyre ndërmjet njeri-tjetrit (5:55). Qëllimi i xhihadit të tyre është vetëm pëlqimi i Allahut, e jo pasuria e kësaj bote. Andaj, ata janë të përlulur para Allahut, të rënë në sexhde pranë Tij dhe Atij do t'i kërkojnë bekimin, pra gjërat materiale, por që shoqërojnë edhe pëlqimin e Allahut të Madhërisëm. Këto janë cilësitë themelore të xhihadit të tyre, të cilat janë përmendur edhe në Teurat në lidhje me ta. Për sa i përket, pjesës së mëvonshme të *umetit* të Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, pra atyre që do të ishin në kohën e Mesihut të Premtuar dhe që do ta pranonin atë, shembulli i tyre që është përmendur në Inxhil, është ai i një are që mbillet e zhvillohet gradualisht, derisa qëndron e fortë në kërcellin e saj. Mbjellësit e saj, pra ata të cilët do të kontribuojnë duke i shërbyer, do të gëzohen shumë duke e parë lulëzimin e saj, gjë që do të shkaktojë zilinë dhe zemëratën e mohuesve. Në fund tha se edhe atyre që besojnë me sinqeritet dhe do t'i kërkojnë falje Allahut, Allahu u jep lajmin e mirë të faljes dhe të shpërblimit të madh. Fjalët “Ky është shembulli i tyre në Teurat”, mund t'i referohen përshkrimit që përmendet në Dhiatën e Vjetër: “Zoti erdhi nga Sinai dhe u ngrit mbi ta në Seir; u paraqit në madhësitinë e tij nga mali Paran, arriti bashkë me dhjetë mijë shenjtorë; nga dora e tij e djathtë, dilte për ta një ligj i zjarhtë.” (Ligji i Përtërirë 33:2, përkthim nga varianti i famshëm “King James” i anglishtes). Kurse fjalët “shembulli i tyre në Inxhil është ai i një are”, mund t'i referohen një përshkrimi tjetër të Dhiatës së Re, që thotë: “Dhe ai u paraqiti shumë gjëra në shëmbëlltëri, duke thënë: “Ja, një mbjellës doli për të mbjellë. Ndërsa po mbillte, një pjesë e farës ra përgjatë rrugës; dhe zogjtë erdhën dhe e hëngrën. Një pjesë tjetër ra në gurishte, ku nuk kishte shumë tokë, dhe mbiu shpejt sepse terreni nuk ishte i thellë; por kur doli dielli u fishk dhe u tha sepse s'kishte rrënjë. Një pjesë tjetër ra midis ferrave dhe ferrat u rritën dhe ia zunë frymën. Një tjetër ra në tokë të mirë dhe dha fryt duke dhënë njëra njëqindfish, tjetra gjashtëdhjetëfish dhe tjetra tridhjetëfish. Kush ka vesh për të dëgjuar, le të dëgjojë!” (Mateu 13:3-9)



## Surja 49 – El-Huxhurat

Surja El-Huxhurat zbriti në Medinë, pas Çlirimit të Mekës. Bashkë me *bismil-lahin* ajo ka nëntëmbëdhjetë ajete.

Surja e mëparshme shpalosi disa nga vetitë e *madhështisë* dhe të *hijeshisë* së Profetit Muhammed<sup>savs</sup>. Pas asaj, kjo sure u kujton sahabëve<sup>ra</sup> përgjegjësitë e tyre duke u thënë: Ju duhet ta respektoni caq shumë këtë Profet madhor, saqë nuk ju ka hije as të flisni sy me sy e as të ngrini zërin përpara tij. Kështu që, Allahu i Madhërisëm shprehu pakënaqësinë e Tij ndaj atyre të cilët e thërrisnin Profetin<sup>savs</sup> duke qëndruar jashtë shtëpisë së tij, që ai të linte punët e tij për t'i takuar ata.

Pas kësaj, në ajetin nr. 10, duke parashikuar që në të ardhmen do të ndërtoheshin shtete muslimane, dhe do të lindnin mosmarrëveshje mes tyre, kjo sure u jep mësimin sesi t'i zgjidhnin mosmarrëveshjet e tyre në mënyrën më të mirë. Ajo që duhet të kemi parasysh është fakti që shtetet muslimane kurrë nuk do të luftonin me njëri-tjetrin në prani të të Dërguarit të Allahut<sup>savs</sup>. Prandaj, ky ajet sjell një kartë pajtuese për shtetet e fuqishme islamike që do të lindnin në të ardhmen, njëherësh të njëjtin mësim u jep edhe shteteve jomuslimane. Pikat kryesore të kësaj karte janë:

- 1) Nëse dy shtete islamike do të luftojnë me njëra-tjetrën, shtetet e tjera islamike e kanë për detyrë të bashkohen për t'i ndalur ato nga lufta, dhe nëse ndonjëra prej tyre nuk e pranon këshillën, të marrin masat ushtarake kundër saj.
- 2) Kur ato tërhiqen nga lufta, shtetet e bashkuara muslimane të bëjnë përpjekje për të bërë pajtim mes tyre.
- 3) Gjatë përpjekjeve për të bërë pajtimin, ato duhet të punojnë me drejtësi absolute ndaj të dyja palëve, sepse rezultati përfundimtar është që Allahu i Madhërisëm i do ata që bëjnë drejtësi, dhe Allahu i Madhërisëm kurrë nuk i bën të dashurit e Tij të dështojnë.

Le të theksojmë edhe një herë. Këto ajete, pavarësisht se u drejtohen muslimanëve, mësimet që mbartin, vlejné për të gjithë njerëzimin.

Pas kësaj, kjo sure përmend një prej shkaqeve kryesore të përçarjes dhe të urrejtjes mes popujve, që është nacionalizmi racist. Çdo popull që përqesh popullin tjetër, e kujton veten më të lartë në pozitë dhe në racë se ai. Në vijim janë përmendur disa probleme të tjera shoqërore, të cilat gjithashtu krijojnë përçarje.

Më pas, kjo sure tregon edhe arsyen se pse Allahu i Madhërisëm i krijoi njerëzit me gjuhë dhe raca të ndryshme. Tha se qëllimi nuk është që një popull të shpallë epërsinë e tij mbi të tjerët, por që popujt të njohin lehtësisht njëri-tjetrin. Për shembull, nëse thuhet se ai është amerikan ose gjerman, kjo të mos jetë për të treguar epërsinë e tij dhe të popullit të tij ndaj popujve të tjerë, por vetëm për ta identifikuar atë.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. O ju që besuat! Mos e vendosni veten tuaj përpara Allahut dhe të Dërguarit të Tij, dhe kini druajtje ndaj Allahut! Sigurisht, Allahu është Gjithëdëgjues, i Gjithëdijshëm.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَقْدِمُوا بَيْنَ يَدَيْ  
اللَّهِ وَرَسُولِهِ وَأَنْتُمْ تَعْلَمُونَ ①  
إِنَّ اللَّهَ سَمِيعٌ  
عَلِيمٌ ①

3. O ju që besuat! Mos ngrini zërin tuaj mbi zërin e Profetit, dhe mos i flisni me zë të lartë, siç flisni me njëritjetrin, që të mos ju zhvlerësohen veprat, e ju të jeni të pavetëdijshëm!

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَرْفَعُوا أَصْوَاتَكُمْ  
فَوْقَ صَوْتِ النَّبِيِّ وَلَا تَجْهَرُوا لَهُ بِالْقَوْلِ  
كَجَهْرِ بَعْضِكُمْ لِبَعْضٍ أَنْ تَحْبَطَ أَعْمَالُكُمْ  
وَأَنْتُمْ لَا تَشْعُرُونَ ①

4. Atyre që ulin zërin pranë të Dërguarit të Allahut, Allahu ua ka provuar zemrat për druajtjen (ndaj Tij). Ata do të kenë falje e shpërblim madhor.

إِنَّ الَّذِينَ يُخَفِّصُونَ أَصْوَاتَهُمْ عِنْدَ رَسُولِ  
اللَّهِ أُولَئِكَ الَّذِينَ امْتَحَنَ اللَّهُ قُلُوبَهُمْ  
لِلنَّبَا ① لَهُمْ مَغْفِرَةٌ وَأَجْرٌ عَظِيمٌ ①

5. Ata që të thërrasin ty nga jashtë shtëpive (të tua), shumica prej tyre nuk kuptojnë.

إِنَّ الَّذِينَ ينادُونَكَ مِنْ وَرَاءِ الْحُجُرَاتِ  
أَكْثَرُهُمْ لَا يَعْقِلُونَ ①

6. Po të kishin duruar derisa ti t'u dilje, do të ishte mirë për ta. Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

وَلَوْ أَنَّهُمْ صَبَرُوا حَتَّى تَخْرُجَ إِلَيْهِمْ  
لَكَانَ خَيْرًا لَّهُمْ ① وَاللَّهُ غَفُورٌ رَحِيمٌ ①

1. Këto ajete tregojnë se ai që shkëput tërësisht lidhjen e tij me të Dërguarin e Zotit dhe hedh hapin përpara hapit të Profetit dhe mjaftohet me idenë e tij për Njëshmërinë e Zotit (që në fakt nuk është Njëshmëria e vërtetë e Zotit, por thjesht e pretenduar si e tillë), atij i zhvlerësohen veprat, ai e humb besimin dhe nuk e gjen dot shpëtimin.

7. O ju që besuat! Nëse ju vjen ndonjë i pabindur me ndonjë lajm, kontrollojeni mirë (atë), që të mos dëmtoni ndonjë popull nga padija, e më pas të mbeteni të penduar për atë që keni bërë.<sup>2</sup>

8. Dhe dini se mes jush keni të Dërguarin e Allahut. Po të pranonte ai shumë nga porositë tuaja, ju do të vështirësoheshit, por Allahu jua bëri të dashur e të bukur besimin në zemrat tuaja, dhe ju dha urrejtje për mohimin, ligësinë dhe mosbindjen; pikërisht këta janë të udhëzuarit;

9. si një bekim e dhuratë prej Allahut. Allahu është i Gjithëdijshëm, i Urtë.

10. Nëse dy grupe nga besimtarët luftojnë me njëri-tjetrin, bëni pajtim mes tyre. Nëse njëri prej të dyve rebelohet mbi tjetrin, luftoni kundër atij që është rebeluar, derisa ai të kthehet te vendimi i Allahut. E kur kthehet, pajtojini me rregullsi dhe bëni drejtësi. Sigurisht, Allahu i do ata që punojnë me drejtësi.<sup>3</sup>

11. Pa dyshim, besimtarët janë vëllezër, andaj, bëni pajtim mes

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِن جَاءَكُمْ فَاسِقٌ بِنَبَأٍ فَتَبَيَّنُوا أَن تُصِيبُوا قَوْمًا بِجَهَالَةٍ فَتُصِحُّوا عَلَى مَا فَعَلْتُمْ نَادِمِينَ ۝

وَاعْلَمُوا أَن فِيكُمْ رَسُولَ اللَّهِ لَوْ يُطِيعُكُمْ فِي كَثِيرٍ مِّنَ الْأَمْرِ لَنَعْتُمْ وَلَكِنَّ اللَّهَ حَبَّبَ إِلَيْكُمُ الْإِيمَانَ وَزَيَّنَهُ فِي قُلُوبِكُمْ وَكَرَّهَ إِلَيْكُمُ الْكُفْرَ وَالْفُسُوقَ وَالْعِصْيَانَ ۗ أُولَٰئِكَ هُمُ الرُّشْدُونَ ۝

فَضَلَّا مِّنَ اللَّهِ وَنِعْمَ ۗ وَاللَّهُ عَلِيمٌ حَكِيمٌ ۝

وَإِنْ طَافْتِنِ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ اقْتَتَلُوا فَأْصَلِحُوا بَيْنَهُمَا ۚ فَإِنْ بَغَتْ إِحْدَهُمَا عَلَى الْأُخْرَىٰ فَقَاتِلُوا الَّتِي تَبْغِي حَتَّىٰ تَفِيءَ إِلَىٰ أَمْرِ اللَّهِ ۚ فَإِنْ فَاءَتْ فَأْصَلِحُوا بَيْنَهُمَا بِالْعَدْلِ وَأَقْسِطُوا ۚ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُقْسِطِينَ ۝

إِنَّمَا الْمُؤْمِنُونَ إِخْوَةٌ فَأْصَلِحُوا بَيْنَ

2. Në Medinë kishte shumë shpifës që shpifnin ndaj njerëzve në atë mënyrë, që disa muslimanë filluan të ushqenin dyshime ndaj tyre dhe menduan edhe të luftonin me ta. Zoti i Madhërishtëm u ndaloi rreptësisht nxitime të tilla, sepse mundej që vetëm për shkak të shpifjeve e të thashethemeve, të dëmtoheshin disa të pafajshëm dhe, rrjedhimisht, besimtarët të turpëroheshin, pasi e vërteta të dilte në shesh.

3. Lexoni shpjegimin në parathënien e sures.

vëllezërve tuaj dhe kini druajtje ndaj Allahut, që të mëshiroheni.

12. O ju që besuat! Asnjë popull nuk duhet të përqeshë popullin tjetër; mundet që ata të jenë më të mirë se këta. As gratë (nuk duhet të përqeshin) gratë e tjera; mundet që ato të jenë më të mira se këto. Mos akuzoni kot njëri-tjetrin dhe mos i ngjisni nofka të këqija njëri-tjetrit. Është shumë e keqe njolla e ligësisë pas besimit. Dhe ata që nuk pendohen, janë keqbërës.<sup>4</sup>

13. O ju që besuat, ruhuni shumë nga paragjykimet! Pa dyshim, disa paragjytime janë mëkat. Mos spiunoni dhe mos përgojoni njëri-tjetrin. A do të pëlqente ndokush prej jush që të hajë mishin e vëllait të tij të

أَخْوِيكُمْ وَاتَّقُوا اللَّهَ لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ ﴿١٢﴾

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا يَسْخَرُ قَوْمٌ مِّنْ قَوْمٍ عَسَىٰ أَن يَكُونُوا خَيْرًا مِّنْهُمْ وَلَا نِسَاءً مِّنْ نِّسَاءٍ عَسَىٰ أَن يَكُنَّ خَيْرًا مِّنْهُنَّ ۚ وَلَا تَلْمِزُوا أَنفُسَكُمْ وَلَا تَنَابَرُوا بِاللِّقَابِ ۗ بئْسَ الْإِسْمُ الْفُسُوقِ بَعْدَ الْإِيمَانِ ۚ وَمَنْ لَّمْ يَتُبْ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الظَّالِمُونَ ﴿١٣﴾

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اجْتَنِبُوا كَثِيرًا مِّنَ الظَّنِّ ۗ إِنَّ بَعْضَ الظَّنِّ إِثْمٌ وَلَا تَجَسَّسُوا وَلَا يَغْتَبَّ بَعْضُكُم بَعْضًا ۗ أَيُحِبُّ أَحَدُكُمْ أَن يَأْكُلَ لَحْمَ أَخِيهِ مَيْتًا فَكَرِهْتُمُوهُ ۗ

4. Sot ka sekte muslimane, të cilat për shkak të grindjeve mes njëra-tjetrës, e quajnë *qafir* njëri-tjetrin. Shikoni se këtu Allahu i Madhërishëm flet për dy grupe muslimane (në ajetin 10) që hyjnë në luftë me njëra-tjetrën, dhe edhe pse njëra prej tyre e dhunon tjetrën, prapëseprapë Allahu që të dyja i quan si grupe besimtare, vëllezër të njëri-tjetrit (ajeti 11), dhe asnjërin prej tyre nuk e quan *qafir*. Madje, ua shpreh pakënaqësinë e Tij ndaj muslimanëve që ndërmarrin veprime të tilla, duke thënë – Pse i ngjisni emërtime të këqija njëri-tjetrit?! Pse u vini damka të këqija njerëzve tuaj?! Pse nuk ua mbuloni dobësitë njëri-tjetrit?! Pse e përqeshni dhe e përgojoni njëri-tjetrin?! Pse e paragjykoni njëri-tjetrin?! Ndërkohë, ata që sillen në këtë mënyrë, Allahu i Madhërishëm i ka quajtur si të dalë nga bindja ndaj Tij, pavarësisht se e kishin përqafuar një herë besimin, dhe thotë janë ata që janë zullumqarë, dhe zullumqarëve Ai u zemërohet. Allahu kurrseksi nuk do që robërit e Tij të shajnë muslimanët dhe besimtarët e tjerë. Pra, shikoni se pavarësisht se Allahu Vetë e cilëson një grup të besimtarëve si rebel e zullumqar, por prapëseprapë atij nuk ia heq titullin e muslimanit, në mënyrë që t'u japë mësim muslimanëve sesi duhet të jenë ata me njëri-tjetrin. Duke i shpjeguar si më sipër këto ajete, Hazret Imam Mehdiu<sup>as</sup> u drejtohet muslimanëve dhe thotë: “*Andaj, nëse keni druajtje ndaj Allahut, këto ajete janë të mjaftueshme për t’ju hapur sytë. Mos e çoni veten atje ku ju prekin dhe ju zënë këto ajete. Mos u nxitoni t’i ndiqni ato punë që mund t’ju shkatërrojnë ju. Largohuni prej atyre që janë zullumqarë ndaj të tjerëve.*” (“*Ruhani Khazain*”, vëll. VIII, “*Sirrul-khilafeh*” (botimi i parë në arabisht, korrik, 1894, Amritser, Indi), 2009, UK, f. 330) Lexoni edhe 4:95.

vdekur?! Ju patjetër që e urreni këtë. Kini druajtje ndaj Allahut. Pa dyshim, Allahu është shumë Pendimpranues, shumë Mëshirëbërës.

وَاتَّقُوا اللَّهَ ۖ إِنَّ اللَّهَ تَوَّابٌ رَّحِيمٌ ﴿١٦﴾

14. O njerëz! Ne ju krijuam prej mashkulli dhe femre, dhe ju bëmë popuj e fise, që të njiheni me njëri-tjetrin. Pa dyshim, prej jush më i nderuari tek Allahu është ai që është më i druajturi (ndaj Tij). Sigurisht, Allahu është i Gjithëdijshëm, i Gjithinformuar.

يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنَّا خَلَقْنَاكُمْ مِنْ ذَكَرٍ  
وَ أَنْثَىٰ وَجَعَلْنَاكُمْ شُعُوبًا وَقَبَائِلَ  
لِتَعَارَفُوا ۗ إِنَّ أَكْرَمَكُمْ عِنْدَ اللَّهِ  
أَتْقَىٰكُمْ ۖ إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ خَبِيرٌ ﴿١٤﴾

15. Beduinët thanë: “Besuam!”, thuaju: Nuk keni besuar, por thoni ‘u bëmë muslimanë’, sepse besimi ende nuk ka hyrë në zemrat tuaja; dhe nëse i bindeni Allahut e të Dërguarit të Tij, Ai nuk do t’jua pakësojë veprat asnjë grimë. Sigurisht, Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.<sup>5</sup>

قَالَتِ الْأَعْرَابُ آمَنَّا ۗ قُلْ لَمْ تُؤْمِرُوا  
وَلَكِنْ قُولُوا أَسْلَمْنَا وَلَمَّا يَدْخُلِ  
الْإِيمَانُ فِي قُلُوبِكُمْ ۖ وَإِنْ تُطِيعُوا اللَّهَ  
وَرَسُولَهُ لَا يَلِتْكُمْ مِنْ أَعْمَالِكُمْ شَيْئًا  
إِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَحِيمٌ ﴿١٥﴾

16. Në të vërtetë, besimtarët janë ata të cilët besuan në Allah dhe në të Dërguarin e Tij e më pas nuk kanë dyshuar, dhe përpiqen në rrugën e Allahut përmes pasurive dhe jetës së tyre. Pikërisht këta janë të vërtetët.

إِنَّمَا الْمُؤْمِنُونَ الَّذِينَ آمَنُوا بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ  
ثُمَّ لَمْ يَرْتَابُوا وَجَاهَدُوا بِأَمْوَالِهِمْ  
وَأَنْفُسِهِمْ فِي سَبِيلِ اللَّهِ ۗ أُولَٰئِكَ هُمُ  
الصَّادِقُونَ ﴿١٦﴾

17. Pyeti: A po ia mësoni Allahut besimin tuaj?! Kurse Allahu e di gjithçka që është në qiej dhe gjithçka që është në tokë. Allahu është i Gjithëdijshëm për çdo gjë.

قُلْ أَتَعْلَمُونَ اللَّهَ بِدِينِكُمْ ۗ وَاللَّهُ يَعْلَمُ  
مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ ۗ وَاللَّهُ بِكُلِّ  
شَيْءٍ عَلِيمٌ ﴿١٧﴾

5. Ky ajet bën dy përkufizime të ndryshme për besimin (*iman*) dhe për Islamin. Gjithkush mund të thotë me gojë se është besimtar me zemër, por të tillëve u thuhet – ju maksimumi mund të pohoni se jeni muslimanë. Kjo tregon se edhe ata që nuk e kanë në zemër besimin, kanë të drejtën të quajnë veten muslimanë.

18. E quajnë nder për ty që pranuan Islamin. Thuaju: “Mos e quani nder për mua Islamin tuaj, përkundrazi, Allahu ju ka bërë nder që ju udhëzoi drejt besimit, nëse jeni të vërtetë.”

19. Sigurisht, Allahu e di të padukshmen e qiejve dhe të tokës. Dhe Allahu është Gjithëshikuesi i asaj që bëni.

يَمُنُونَ عَلَيْكَ أَنْ أَسْلَمُوا ۗ قُلْ لَا تَمُنُوا  
عَلَيَّ إِسْلَامَكُمْ ۗ بَلِ اللَّهُ يَمُنُّ عَلَيْكُمْ  
أَنْ هَدَيْتُمْ لِلْإِيمَانِ أَنْ كُنْتُمْ صَادِقِينَ ﴿١٨﴾

إِنَّ اللَّهَ يَعْلَمُ غَيْبَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ۗ  
وَاللَّهُ بَصِيرٌ ﴿١٩﴾ بِمَا تَعْمَلُونَ ۚ

## Surja 50 – Kaf

Surja Kaf u zbrit në periudhën e hershme të Mekës. Bashkë me *bismil-lahin*, ka dyzet e gjashtë ajete.

Kjo sure fillon me shkurtesën “*kaf*”, për të cilën disa dijetarë të shquar mendojnë se është shkurtesa e emrit “*Kadir*” të Allahut, që do të thotë “*i Plotfuqishëm*”. Është interesante që fjala e parë menjëherë pas kësaj shkurtese është “*Kuran*”, që gjithashtu fillon me shkronjën “*kaf*”. Dhe ajeti vijues flet për ata që mohojnë fuqinë e Allahut që thonë sesi mund t’u vijë atyre ndonjë alarmues prej Zotit dhe sesi paska fuqi Allahu t’i ringjallë ata për Ditën e Gjykimit, pasi të vdesin e të bëhen pluhur. Sipas tyre kjo është diçka shumë e largët dhe krejt e palogjikshme. Allahu i Madhërishëm thotë – Ne e dimë se çfarë pakëson toka, dhe jemi të Plotfuqishëm t’i mbledhim sërish tërë grimcat e shpërndara. Allahu ua tërheq vëmendjen drejt qiejve të pakufishëm duke u thënë se ata nuk mund të tregojnë dot qoftë një të metë të vogël në gjithë këtë univers gjigant, atëherë si mund ta mohojnë fuqinë e Krijuesit të tij?!

Më pas Zoti i Madhërishëm tha: Unë i di të gjitha dyshimet që lindin në zemrat e njerëzve [që u përmendën më sipër], sepse Unë jam më afër njeriut sesa damari i qafës.

Në vijim vjen edhe profecia që u thotë: Ju patjetër do të ringjallenin dhe do të keni edhe një grahës që do t’ju shtyjë, si dhe një dëshmitar me ju.

Duke përmendur xhehenemin tha: Grupet e të pafeve, njëri pas tjetrit, do të bëhen lëndë djegëse e një xhehenemi të pangopshëm. Me një përshkrim të figurshëm thotë se Zoti do ta pyesë xhehenemin: A u ngope?, e ai do t’i përgjigjet: “Jo! A ka më të ligj të tjerë që të hidhen në barkun tim?”

Krejt e kundërt është pamja e xhenetit, të cilin Zoti i Madhërishëm do t’ua afrojë atyre që patën druajtje ndaj Tij. Po kështu, fjalët “pa aspak largësi” (arab. *gajre baid*), gjithashtu nënkuptojnë se një gjë e tillë nuk është e largët nga logjika [pra, i përgjigjet pyetjes së mohuesve, të përmendur në ajetin nr. 4]. Andaj, Zoti i Madhërishëm e këshillon Profetin Muhammed<sup>savs</sup> që të durojë të gjitha abuzimet dhe sharjet e mohuesve, sepse profecitë që janë përmendur në Kuranin e Shenjtë, do të përmbushen pashmangshmërisht, andaj, i thotë – Vazhdo të këshillosh po përmes Kuranit çdokënd që frikësohet nga paralajmërimi Im. Kjo nuk do të thotë se Profeti Muhammed<sup>savs</sup> duhej të zgjidhte secilin që frikësohej nga paralajmërimi dhe vetëm atë ta këshillonte. Jo, ai do të këshillonte të gjithë njerëzimin, por nga këshilla e tij do të përfitojë vetëm ai që frikësohet nga paralajmërimi.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. *Kaf.* (I Plotfuqishëm.) Beto hem për Kuranin e Nderuar!

قُرْآنَ الْمَجِيدِ ②

3. E vërteta është që ata u çuditën se pse u ka ardhur një alarmues nga gjiri i tyre. Ndaj, mohuesit thanë: “Kjo qenka diçka e çuditshme!

بَلْ عَجَبُوا أَنْ جَاءَهُمْ مُنذِرٌ مِنْهُمْ فَقَالَ الْكٰفِرُونَ هَذَا شَيْءٌ عَجِيبٌ ③

4. Vallë, kur të vdesim e të bëhemi pluhur, (a do të ringjallemi)?! Qenka një kthim shumë i largët (nga logjika)!”

ءِ إِذَا مِنْنَا وَكُنَّا تُرَابًا ۗ ذٰلِكَ رَجْعٌ بَعِيدٌ ④

5. Ne e dimë shumë mirë çfarë pakëson toka prej tyre dhe te Ne kemi një Libër që ruan çdo gjë.

قَدْ عَلِمْنَا مَا تَنْقُصُ الْأَرْضُ مِنْهُمْ ۗ وَعِنْدَنَا كِتَابٌ حَفِيظٌ ⑤

6. Në fakt, ata e quajtën gënjeshtër të vërtetën, kur ajo u erdhi, andaj, janë në gjendje hutimi.

بَلْ كَذَّبُوا بِالْحَقِّ لَمَّا جَاءَهُمْ فَهُمْ فِي أَمْرٍ مَّرِيحٍ ⑥

7. A nuk panë qiellin sipër tyre sesi e ndërtoam, e zbukuruam dhe që nuk ka asnjë të metë?!

أَفَلَمْ يَنْظُرُوا إِلَى السَّمَاءِ فَوْقَهُمْ كَيْفَ بَنَيْنَاهَا وَزَيَّنَّاهَا وَمَا لَهَا مِنْ فُرُوجٍ ⑦

8. Dhe tokën e shtruam; në të vumë edhe male të ngulitura fort, dhe nxorëm çdolloj çifti të këndshëm!

وَالْأَرْضَ مَدَدْنَاهَا وَأَلْقَيْنَا فِيهَا رَوَاسِيَ وَأَنْبَتْنَا فِيهَا مِنْ كُلِّ زَوْجٍ بَهِيجٍ ⑧

9. Për t'i parë me sy dhe si mësim për çdo rob që rikthehet (tek Allahu).

تَبْصِرَةً وَذِكْرًا لِكُلِّ عَبْدٍ مُنِيبٍ ⑨



10. Dhe zbritëm prej qiellit ujë të bekuar, dhe përmes tij nxorëm pemishte dhe farat e të korrave;

وَنَزَّلْنَا مِنَ السَّمَاءِ مَاءً مُّبْرَكًا فَأَنْبَتْنَا بِهِ  
جَبْتًا وَحَبَّ الْحَصِيدِ ۝

11. dhe palma të larta hurmash që kanë vile të ngarkuara;

وَالنَّخْلَ بَسِقَاتٍ لَهَا طَلْعٌ نَضِيدٌ ۝

12. si ushqim për robërit. Dhe Ne përmes tij, (pra shiut), i dhamë jetë një vendi të vdekur. Ja kështu do të jetë (edhe) ringjallja.

رِزْقًا لِلْعِبَادِ ۗ وَأَحْيَيْنَا بِهِ بَلَدَةً مَيِّتًا  
كَذَلِكَ الْخُرُوجُ ۝

13. Para tyre mohuan (edhe) populli i Nuhut, banorët e minierave dhe themudët.

كَذَّبَتْ قَبْلَهُمْ قَوْمُ نُوحٍ وَأَصْحَابُ الرَّسِّ  
وَتَمُودُ ۝

14. Dhe adët, Faraoni dhe vëllezërit e Lutit.

وَعَادَ وَفِرْعَوْنَ وَإِخْوَانَ لُوطِ ۝

15. Dhe banorët e pyjeve dhe populli i Tubbas. Të gjithë i quajtën gënjeshtarë të Dërguarit. Atëherë u vërtetua paralajmërimi Im.

وَأَصْحَابُ الْأَيْكَةِ وَقَوْمِ تُبَيْعٍ ۗ كُلٌّ كَذَّبَ  
الرُّسُلَ فَحَقَّ وَعِيدِ ۝

16. A qenkemi lodhur nga krijimi i parë?! Jo, madje ata janë në dyshim edhe rreth krijimit të ri.

أَفَعَيِينَا بِالْخَلْقِ الْأَوَّلِ ۗ بَلْ هُمْ فِي لَبْسٍ  
بِئْسَ مَنْ خَلَقَ جَدِيدٌ ۝

17. Sigurisht, Ne e krijuam njeriun dhe e dimë edhe atë që i pëshpërit vetja e tij. Dhe Ne jemi më afër tij sesa damari i qafës.<sup>1</sup>

وَلَقَدْ خَلَقْنَا الْإِنْسَانَ وَنَعَلَمُ مَا تُوَسَّوَسُ  
بِهِ نَفْسُهُ ۗ وَنَحْنُ أَقْرَبُ إِلَيْهِ مِنْ حَبْلِ  
الْوَرِيدِ ۝

1. Punët e këqija që bën njeriu fillojnë me ndonjë mendim të keq që i lind në zemër. Një ilaç për të larguar mendime tilla nëse të lindin është që ta ndërrosh vendin ku qëndron, ose të bisedosh me dikë, ose të merresh me ndonjë punë, një punë që mund të keshë lënë pa e bërë prej kohësh, por të mos rrih vetëm, ose të kujtosh vdekjen, ose të recitosh Kuranin e Shenjtë, etj.. Përveç kësaj, në përgjithësi duhet të themi shpesh *La ilah il-lall-Ilah*, (Nuk ka të adhurueshëm tjetër përveç Allahut), *La heule ve la kuvvete il-la bil-lahi* (Sundim dhe fuqi nuk ka tjetërkush përveç Allahut), *Elhamdulil-lah* (Lavdia është e Allahut), duke u thelluar edhe

18. Kur dy regjistrues (engjëj), regjistrojnë gjithçka duke qëndruar në të djathtë dhe në të majtë (të njeriut).<sup>2</sup>

إِذْ يَتَلَقَّى الْمُتَلَقِّينَ عَنِ الْيَمِينِ وَعَنِ الشِّمَالِ قَعِيدًا ۝١٨

19. (Njeriu) nuk shqipton ndonjë fjalë, pa pasur pranë një vëzhgues të gatshëm (që ia shënon fjalën).<sup>3</sup>

مَا يَلْفِظُ مِنْ قَوْلٍ إِلَّا لَدَيْهِ رَقِيبٌ عَتِيدٌ ۝١٩

20. Dhe i vjen agonia e vdekjes me vërtetësi: “Kjo është ajo që e shmangie!”

وَجَاءَتْ سَكْرَةُ الْمَوْتِ بِالْحَقِّ ۗ ذَٰلِكَ مَا كُنْتُمْ مِنْهُ تَحِيدُونَ ۝٢٠

21. Dhe do t'i fryhet bririt. “Kjo është dita e paralajmëruar.”

وَنُفِخَ فِي الصُّورِ ۗ ذَٰلِكَ يَوْمَ الْوَعِيدِ ۝٢١

22. Do të vijë çdo shpirt, së bashku me një grahës e një dëshmitar.

وَجَاءَتْ كُلُّ نَفْسٍ مَّعَهَا سَائِقٌ وَشَهِيدٌ ۝٢٢

në kuptimet e tyre, dhe shpesh t'i kërkojmë falje Zotit e t'i dërgojmë *salavatet* të Dërguarit të Allahut<sup>savs</sup>.

2. Ajeti flet për engjëjt të cilët janë përcaktuar si regjistrues veprash të njeriut. Pra, engjëjt që i rrinë në të djathtën e tij, i shënojnë veprat e tij të mira, dhe engjëjt që i rrinë në të majtë, i shënojnë veprat e tij të këqija. Ajeti nuk pohon që ka engjëj që i rrinë në të dyja anët e njeriut dhe që shikohen me sy truporë, por tregon sistemin e jashtëzakonshëm të dëshmimit që ka krijuar Allahu i Madhërishëm.

3. Besimtari duhet të marrë mësim nga çdo gjë. Teknologjia sot në përgjithësi është bërë mjet argëtimi. Kjo teknologji i ruan njeriut çdo fjalë, çdo dëshirë dhe çdo lëvizje, që më pas, ai vetë mund t'ua zbulojë edhe të tjerëve nëse do. Në të njëjtën mënyrë, Kurani në këtë ajet pohon se çdo gjë që ai shqipton, po ia ruan një regjistrues, sepse efekti i fjalëve dhe i veprave të tij po shënohet në gjymtyrët dhe në grimcat që e rrethojnë, të gjitha këto, një ditë mund të dalin në shesh. Ashtu siç ai nuk do të dëshironte që teknologjia t'ia nxirrte në shesh fjalët ose veprimet e tij të këqija, i duhet të ruhet nga momenti kur ato dhe shumë të tjera që as teknologjia nuk i llogarit dot, mund t'i dalin të zbuluara përmes sistemit të gjykimit që ka ndërtuar Zoti i Madhërishëm. Pra, ky ajet tregon se po vjen një ditë kur gjithçka do të zbulohet. Atëherë ai që tha fjalë të padenja ose bëri vepra të këqija, do të turpërohet. Kjo për një njeri të edukuar është më keq se ndëshkimi. Andaj, ne duhet të bëjmë përmirësimin përpara se të vijë një kohë e tillë dhe t'i kërkojmë mbrojtje Allahut, duke iu lutur Atij.

23. “Ti ke qenë në shkujdesje ndaj kësaj. Ja që ta hoqëm perden, dhe shikimi sot t’u bë shumë i mprehtë!”<sup>4</sup>

لَقَدْ كُنْتَ فِي غَفْلَةٍ مِّنْ هَذَا فَكَشَفْنَا  
عَنْكَ غِطَاءَكَ فَبَصَرُكَ الْيَوْمَ حَدِيدٌ ﴿٢٣﴾

24. Dhe shoqëruesi i tij do të thotë: “Ky që kam unë është gati”.

وَقَالَ قَرِينُهُ هَذَا مَا لَدَىٰ عَيْنِي ﴿٢٤﴾

25. “(O grahës dhe, o dëshmitar!) Hidheni në xhehenem çdo mosmirënjohës, rebel;

الْفِيَا فِي جَهَنَّمَ كُلَّ كَفَّارٍ عَنِيدٍ ﴿٢٥﴾

26. çdo ndalues të mirësisë, shkelës, dyshues;

مَنَاعٍ لِلْخَيْرِ مُعْتَدٍ مُّرِيْبٍ ﴿٢٦﴾

27. i cili i bëri të adhurueshëm tjetër Allahut. Andaj, ju të dy, flakeni atë në ndëshkimin e fortë.”

الَّذِي جَعَلَ مَعَ اللَّهِ إِلَهًا آخَرَ فَأَلْقِيهِ فِي  
الْعَذَابِ الشَّدِيدِ ﴿٢٧﴾

28. Shoku i tij do të thotë: “O Zoti ynë! Nuk e kam bërë unë rebel këtë, përkundrazi, ai vetë ishte në devijim të thellë.”

قَالَ قَرِينُهُ رَبَّنَا مَا أَطَعَيْتُهُ وَلَكِنْ كَانَ  
فِي ضَلَالٍ بَعِيدٍ ﴿٢٨﴾

29. (Allahu) do të thotë: Mos u grindni pranë Meje. Unë jua kisha dërguar paralajmërimin.

قَالَ لَا تَخْتَصِمُوا لَدَىٰ وَقَدْ قَدَّمْتُ إِلَيْكُمْ  
بِالْوَعِيدِ ﴿٢٩﴾

30. Unë nuk e ndërroj fjalën dhe as nuk u bëj padrejtësi robërve.

مَا يَبْدُلُ الْقَوْلُ لَدَىٰ وَمَا أَنَا بِظَلَّامٍ  
لِّلْعَبِيدِ ﴿٣٠﴾

31. Ditën kur do ta pyesim xhehenemin: “A u mbushë?”, dhe ai do të përgjigjet: “A ka më shumë?”<sup>5</sup>

يَوْمَ نَقُولُ لِجَهَنَّمَ هَلِ امْتَلَأَتْ وَتَقُولُ  
هَلْ مِنْ مَّزِيدٍ ﴿٣١﴾

4. Në botën tjetër do të hiqet “perdja” nga sytë e njeriut dhe shikimi dhe perceptimi i tij mendor do të bëhen më të qarta dhe më të mprehta. Ai do t’i shohë pasojat e veprimeve të tij në një formë fizike, që sytë e tij në këtë botë nuk arrinin ta shikonin. Pra, ajo që ai e mendonte si iluzion në këtë botë, në botën tjetër do të bëhet krejt reale dhe e prekshme. Ai do të jetë në gjendje të shohë përmasat e dëmit ose të dobisë që mund t’i ketë shkaktuar shpirtit të vet.

5. Ky dialog është në një gjuhë konotative (metaforë). Ferri ose xhehenemi është personifikuar

32. Edhe xheneti do t'u afrohet të druajturve (ndaj Zotit), pa aspak largësi.<sup>6</sup>

وَأُرْلِفَتِ الْجَنَّةُ لِلْمُتَّقِينَ غَيْرَ بَعِيدٍ ﴿٦٠﴾

33. Kjo është ajo që ju premtohet; për çdokënd që vazhdimisht kthehet (te Zoti, dhe që), mbikëqyr (veprat e veta);

هَذَا مَا تُوعَدُونَ لِكُلِّ أَوَّابٍ حَفِيظٍ ﴿٦١﴾

34. që i frikësohet të Gjithë-mëshirshmit kur është i vetëm dhe vjen me zemër të përlulur.

مَنْ خَشِيَ الرَّحْمَنَ بِالْغَيْبِ وَجَاءَ بِقَلْبٍ مُنِيبٍ ﴿٦٢﴾

35. “Hyni paqësisht në të! Kjo është dita e përjetësisë.”

ادْخُلُوهَا بِسَلَامٍ ۗ ذَلِكَ يَوْمُ الْخُلُودِ ﴿٦٣﴾

36. Ata në të do të kenë gjithçka që do të dëshirojnë, dhe te Ne ka edhe më shumë.<sup>7</sup>

لَهُمْ مَا يَشَاءُونَ فِيهَا وَلَدَيْنَا مَزِيدٌ ﴿٦٤﴾

37. Sa shumë popuj përpara tyre kemi shkatërruar, të cilët ishin më të fortë se këta në ndëshkim! Ata gërmuan në tokë (por), a gjetën rrugëdalje?!

وَكَمْ أَهْلَكْنَا قَبْلَهُمْ مِنْ قَرْنٍ هُمْ أَشَدُّ مِنْهُمْ بَطْشًا فَنَقَّبُوا فِي الْبِلَادِ ۗ هَلْ مِنْ مَّجِيسٍ ﴿٦٥﴾

38. Sigurisht, në të ka një mësim për çdokënd që ka zemër, ose vë veshin dhe sheh.

إِنَّ فِي ذَلِكَ لَذِكْرٍ لِمَنْ كَانَ لَهُ قَلْبٌ أَوْ أَلْقَى السَّمْعَ وَهُوَ شَهِيدٌ ﴿٦٦﴾

këtu, dhe ai do të tregojë gjendjen e tij në mënyrë tejet reale. Folja “kāle” (them) diku tjetër në Kuran është përdorur po në kuptimin metaforik edhe për qiellin dhe Tokën (41:12). Përveç kësaj, kjo shprehje e ferrit, në fakt, tregon edhe ferrnajën që mban njeriu i ligë në shpirtin e tij, dëshirën e tij të pakufishme për të bërë mëkate, pavarësisht nga pamundësia për t'i realizuar ato. Po ky xhehenem i tij i brendshëm do ta çojë atë në xhehenemin e botës së përtejme.

6. Ndërsa në ajetin e mëparshëm përmendet pangopësia e ferrit, ky ajet thotë se edhe parajsja ose xheneti do të afrohet për të drejtët dhe të devotshmit.

7. Të dëlirët do të kenë në xhenet çdo gjë që dëshirojnë për kënaqësinë e zemrës së tyre, por ngaqë e mira nuk ka fund dhe njerëzit e dëlirë nuk mund ta perceptojnë ose nuk mund ta kërkojnë atë me të gjitha përmasat e saj, Zoti Vetë do t'ua sigurojë edhe më shumë. Lexoni edhe 50:31.

39. Pa dyshim, Ne i krijuam qiejt, tokën dhe gjithçka që është mes tyre në gjashtë ditë, dhe nuk Na preku lodhja aspak.<sup>8</sup>

وَلَقَدْ خَلَقْنَا السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ وَمَا بَيْنَهُمَا فِي سِتَّةِ أَيَّامٍ ۗ وَمَا مَسَّنَا مِنْ لُغُوبٍ ﴿٣٩﴾

40. Duroje atë që ata thonë, dhe me lavdërimin e Zotit tënd përkujto (Atë) para lindjes së diellit dhe para perëndimit;

فَاصْبِرْ عَلَىٰ مَا يَقُولُونَ وَسَبِّحْ بِحَمْدِ رَبِّكَ قَبْلَ طُلُوعِ الشَّمْسِ وَقَبْلَ الْغُرُوبِ ﴿٤٠﴾

41. edhe gjatë natës përkujtoje Atë, edhe pas sexhdeve.

وَمِنَ اللَّيْلِ فَسَبِّحْهُ وَأَدْبَارَ السُّجُودِ ﴿٤١﴾

42. Dhe dëgjo me vëmendje! Ditën kur do të thërrasë një thirrës nga një vend i afërt.

وَأَسْمِعْ يَوْمَ يُنَادِ الْمُنَادِ مِنْ مَّكَانٍ قَرِيبٍ ﴿٤٢﴾

43. Ditën kur ata do të dëgjojnë një krisëm të vërtetë. Ajo do të jetë dita e daljes.

يَوْمَ يَسْمَعُونَ الصَّيْحَةَ بِالْحَقِّ ۗ ذَٰلِكَ يَوْمُ الْخُرُوجِ ﴿٤٣﴾

44. Sigurisht, Ne japim jetë e shkaktojmë vdekje dhe po te Ne është kthimi.

إِنَّا نَحْنُ نُحْيِي وَنُمِيتُ وَإِلَيْنَا الْمَصِيرُ ﴿٤٤﴾

45. Ditën kur toka do të çahet me shpejtësi sipër tyre. Ky tubim i madh është i lehtë për Ne.

يَوْمَ تَشَقَّقُ الْأَرْضُ عَنْهُمْ سِرَاعًا ۗ ذَٰلِكَ حَشْرٌ عَلَيْنَا يَسِيرٌ ﴿٤٥﴾

46. Ne e dimë më së miri atë që ata thonë; dhe ti nuk je tiranmbita. Andaj, këshillo përmes Kuranit çdokënd që i frikësohet paralajmërimit Tim.

نَحْنُ أَعْلَمُ بِمَا يَقُولُونَ وَمَا أَنْتَ عَلَيْهِمْ بِجَبَّارٍ ۗ فَذَكِّرْ بِالْقُرْآنِ مَنْ يَخَافُ وَعِيدِ ﴿٤٦﴾

8. Në Bibël përmendet që pas krijimit të qiejve dhe të tokës në gjashtë ditë, “ditën e shtatë Perëndia u çlodh” (Zanafilla 2:2-3). Kjo duhet të ketë qenë ndonjë metaforë, andaj, Kurani nuk e përmend diçka të tillë. Madje, për të larguar një keqkuptim të tillë, Zoti i Madhërisëm e qartëson në Kuranin e Shenjtë duke thënë: “nuk Na preku lodhja aspak”. Pra, këto fjalë hedhin poshtë kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalës “çlodhje”, sepse çlodhet ai që lodhet, kurse Zoti i Madhërisëm është i Pastër nga të meta të tilla.

## Surja 51 – Edh-Dharijat

Surja Edh-Dharijat është një ndër suret e para mekase. Bashkë me *bismil-lahin*, ka gjashtëdhjetë e një ajete.

Që në fillim të kësaj sureje është provuar që profecitë që janë përmendur në suren paraardhëse në lidhje me xhenetin dhe xhehenemin [se çfarë diskutimesh do të bëhen me banorët e xhenetit e të xhehenemit], janë tërësisht të vërteta dhe reale, që sa janë bisedat e njerëzve me njëri-tjetrin në këtë botë.

Kjo sure edhe një herë sjell si dëshmi luftërat e kohëve të ardhshme, në mënyrë që njerëzit kur të shohin se profecitë u përmbushën, të mos kenë më dyshime rreth së padukshmes që Allahu i Madhërishëm ia zbuloi Profetit Muhammed<sup>saws</sup>, qofshin ato profeci që lidhen me jetën e kësaj bote, qofshin ato që lidhen me botën tjetër.

Kështu që, surja fillon: “Betohem për shpërndarësit e farave!” Kjo profeci tashmë është përmbushur edhe fjalë për fjalë, sepse sot ne shohim me sytë tanë sesi avionët dhe helikopterët shpërndajnë farat nëpër tokë. Këto mjete fluturojnë duke mbartur edhe barra shumë të rënda, dhe pavarësisht nga pesha e tyre e madhe, ecin me shpejtësi, pa pengesë. Po kështu, me këta avionë u dërgohen informacione të rëndësishme edhe vendeve të fuqishme, edhe vendeve të dobëta vasale. Duke i sjellë të gjitha këto gjëra si dëshmi, kjo sure nxjerr përfundimin se edhe premtimi që po ju jepet, do të përmbushet patjetër dhe se edhe dita e gjykimit për superfuqitë e botës do të ndodhë edhe në këtë botë, po kështu edhe për mbarë njerëzit në jetën e përtejme.

Pas kësaj, në një ajet tjetër është sqaruar se këto shpërndarëse të farave dhe mbartëse të peshave nuk ecin në sipërfaqen e tokës, por i kanë rrugët në qiell. Kështu që, është sjell si dëshmitar qielli që është plot me rrugë. Sot kur shikojmë lart, i shohim me sy rrugët ajrore në qiell. Duke i paraqitur të gjitha këto dëshmi, njerëzve u jepet një mesazh – Po gaboni rëndë duke e mohuar botën e përtejme, sepse, nëse këto fjalë që solli i Dërguari i Allahut, *ma’adhallah*, do të ishin thjesht hamendësime, atëherë hamendësuesit në këtë fushë shkatërrohen pa përjashtim, kurse ky Profet do të mbetet përgjithmonë.

Ligjërimi i kësaj sureje është një kartolinë e shprehësisë. Pasi përmendi shpërndarësit e farave prej qiellit, u tërheq vëmendjen njerëzve duke thënë: të gjitha mjetet e furnizimit tuaj vijnë prej qiellit, dhe se ka edhe një ushqim qiellor, sekretin e të cilit njeriu nuk e kupton dot, dhe po ky ushqim u jepet edhe engjëjve. Surja përmend mysafirët e *Hazret Ibrahimit*<sup>as</sup>, të cilët ishin engjëj por që i shfaqen në formë njerëzish. Kur *Hazret Ibrahim*<sup>as</sup> u shërben me ushqimin që është bazë e mbijetesës së njeriut, ata e refuzojnë, sepse ata furnizohen me tjetër lloj ushqimi. Pas *Hazret Ibrahimit*<sup>as</sup>, kjo sure përmend edhe shumë Profetë të tjerë.

Pas kësaj vjen një ajet i cili thotë se qielli është gjithnjë duke u zgjeruar, gjë që asnjë

njeri i kohës së Profetit Muhammed<sup>savs</sup> as nuk mund ta imagjinonte dot. Vetëm në këtë kohë, kozmologët e zbuluan këtë fakt shkencor që qielli ose hapësira është gjithmonë duke u zgjeruar, madje, pasi të arrijë në një pikë që quhet “afati i caktuar” (arab. *exhelun musem-ma*), ajo do të kthehet aty ku ishte nisur.

Kjo sure e paraqiti temën e ushqimit në atë mënyrë që pohon se të gjithë janë nevojtarë të ndonjë ushqimi, qofshin njerëzit, qofshin engjëjt, dhe vetëm Një Qenie është e Pavarur nga ushqimi: Allahu i Madhërishëm, dhe pikërisht Ai është Ushqyesi i të gjithëve.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithë-  
mëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Beto hem për shpërndarëset (e  
farave)!

وَالدَّرَجَاتِ ذَرَوًا ①

3. Dhe për mbartëset e peshave!

فَالْحِمْلِتِ وَقِرًا ①

4. Dhe për lëvizëset e rrjedhshme!

فَالْجُرِيَّتِ يُسْرًا ①

5. Dhe për ndarëset e urdhrave!¹

فَالْمَقْسَمِتِ أَمْرًا ①

6. Ajo që ju premtohet, është  
plotësisht e vërtetë.

إِنَّمَا تُوعَدُونَ لَصَادِقٌ ①

7. Dhe Dita e Gjykimit patjetër do të  
ndodhë.

وَإِنَّ الدِّينَ لَوَاقِعٌ ①

8. Dhe betohem për qiellin me plot  
rrugë!

وَالسَّمَاءِ ذَاتِ الْجُبِّكَ ①

9. Ju gjendeni në një fjalë kontra-  
diktore,

إِنَّكُمْ لِنَفِي قَوْلٍ مُّخْتَلِفٍ ①

1. Ajetet 2-5: Këto ajete interpretohen me kuptime të ndryshme. Një prej tyre u përmend në parathënien e sures. Një kuptim tjetër i këtyre ajeteve është që ato flasin për erërat dhe engjëjt. Në këtë kontekst, zërthimi i ajeteve është: Beto hem për erërat që ndajnë avujt nga ujërat! Beto hem për erërat që i mbartin avujt e rëndë! Beto hem për erërat që lëvizin për t'i çuar retë e ngarkuara në destinacionet e duhura! Beto hem për engjëjt që luajnë rolin e shpërndarjes së këtyre çështjeve! Pra, ajetet pohojnë se erërat janë asgjë, dhe se ato vetë nuk janë të vetëdijshme as për t'i marrë avujt nga detet, as për t'i ngarkuar retë me to e më pas, as për t'i shpënë retë aty ku duhet. Pra këtu nuk vepron arbitrariteti, por logjika e shpërndarjes së çështjeve. Andaj, mbrapa perdes veprojnë engjëjt e Zotit. Në këtë mënyrë, Zoti i Madhërisëm në këto ajete së pari tregoi faktorët e jashtëm të shiut, pra, ciklin e ujit, dhe në fund, në betimin për shpërndarëset e çështjeve, shpalosi që këtu nuk vepron vetëm ligji fizik i shkaq-pasojës, i vendosur nga Zoti, por mbrapa tyre vepron edhe një ligj tjetër shpirtëror i shkaqeve, dhe është pikërisht ky i fundit që e mban në këmbë të parin.



10. Për shkak të së cilës, shmanget (nga e vërteta) ai që (është i destinuar të) shmanget.

يُؤْفَاكُ عَنْهُ مَنْ أُفِكَ ۝

11. U shkatërrofshin hamendësuesit!

قَتَلَ الْخَرْصُونَ ۝

12. Të cilët po vërtiten në shkujdesje.

الَّذِينَ هُمْ فِي غَمْرَةٍ سَاهُونَ ۝

13. Pyesin: “Kur do të ndodhë Dita e Gjykimit?”

يَسْأَلُونَ أَيَّانَ يَوْمِ الدِّينِ ۝

14. Ditën kur ata do të piqen në zjarr.

يَوْمَ هُمْ عَلَى النَّارِ يُفْتَنُونَ ۝

15. “Shijoni ngatërresën tuaj! Kjo është ajo që e kërkonit me nxitim!”

ذُوقُوا فِتْنَتَكُمْ ۗ هَذَا الَّذِي كُنْتُمْ بِهِ

تَسْتَعْجِلُونَ ۝

16. Sigurisht, të druajturit (ndaj Zotit) do të jenë në kopshte e burime.

إِنَّ الْمُتَّقِينَ فِي جَنَّاتٍ وَعَيْونَ ۝

17. Do të marrin atë që Zoti i tyre do t’ua japë. Pa dyshim, këta deri më parë kanë qenë mirëbërës.

أَخْذِينَ مَا أَنعَمَ رَبُّهُمْ ۗ إِنَّهُمْ كَانُوا قَبْلَ

ذَلِكَ مُحْسِنِينَ ۝

18. Pak flinin natën.

كَانُوا قَلِيلًا مِّنَ اللَّيْلِ مَا يَهْجَعُونَ ۝

19. Edhe gjatë agimeve i kërkonin falje Zotit.

وَبِالْأَسْحَارِ هُمْ يَسْتَغْفِرُونَ ۝

20. Në pasuritë e tyre kishte pjesë edhe lypësi, edhe ata (nevojtarë) që nuk lypnin.

وَفِي أَمْوَالِهِمْ حَقٌّ لِّلسَّائِلِ وَالْمَحْرُومِ ۝

21. Edhe në tokë ka shenja për ata që besojnë.

وَفِي الْأَرْضِ آيَاتٌ لِّلْمُوقِنِينَ ۝

22. Edhe në veten tuaj. A nuk shikoni?!

وَفِي أَنفُسِكُمْ أَفَلَا تُبْصِرُونَ ۝

23. Dhe në qiell është ushqimi juaj, si dhe ajo që ju premtohet.

وَفِي السَّمَاءِ رِزْقُكُمْ وَمَا تُوعَدُونَ ۝

24. Beto hem për Zotin e qiellit dhe të tokës! Kjo pa dyshim është e vërtetë, siç është të folurit tuaj (me njëri-tjetrin).

فَو رَبِّ السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ إِنَّهُ لَحَقٌّ  
مِّثْلَ مَا أَنْكُمْ تُطْفُونَ ﴿١٤﴾

25. A ju ka ardhur lajmi i mysafirëve të nderuar të Ibrahimit?

هَلْ أَتَاكَ حَدِيثٌ صَيفِ إِبْرَاهِيمَ  
الْمُكْرَمِينَ ﴿١٥﴾

26. Kur ata hynë te ai dhe thanë salam. (Edhe) ai u tha salam, (dhe me vete tha) “njerëz të panjohur (me duken)”.

إِذْ دَخَلُوا عَلَيْهِ فَقَالُوا سَلَامًا قَالَ سَلَامٌ  
قَوْمٍ مُنْكَرُونَ ﴿١٦﴾

27. Shkoi nxitimthi te familja e tij dhe solli një viç të majmë (të pjekur).

فَرَأَى إِلَى أَهْلِهِ فَجَاءَ بِعَجَلٍ سَيْنٍ ﴿١٧﴾

28. Ua afroi (dhe i) pyeti: “A nuk do ta hani?!”

فَقَرَّبَهُ إِلَيْهِمْ قَالَ أَلَا تَأْكُلُونَ ﴿١٨﴾

29. Atëherë ndjeu frikë prej tyre. Ata thanë: “Mos ki frikë!” Dhe i dhanë lajmin e mirë të një djali të dijsëm.

فَأَوْجَسَ مِنْهُمْ خِيفَةً ۖ قَالُوا لَا تَخَفْ  
وَبَشِّرُوهُ بِبُعْلِ عَالِيَةٍ ﴿١٩﴾

30. Atëherë gruaja e tij doli përpara duke bërtitur, përplasi fytyrën me duart dhe tha: “Jam e plakur, shterpë!”

فَأَقْبَلَتِ امْرَأَتُهُ فِي صَرََّةٍ فَصَكَتْ وَجْهَهَا  
وَقَالَتْ عَجُوزٌ عَقِيمٌ ﴿٢٠﴾

31. Kështu është, thanë ata, Zoti yt tha: “Pikërisht Ai është i Urti, i Gjithëdijshmi”.

قَالُوا كَذَلِكَ قَالَ رَبُّكَ ۗ إِنَّهُ هُوَ الْحَكِيمُ  
الْعَلِيمُ ﴿٢١﴾

Xhuzi 27

32. (Ibrahimi) tha: “Cili është qëllimi juaj, o të dërguar?”

قَالَ قَالَ فَمَا خَطْبُكُمْ أَيُّهَا الْمُرْسَلُونَ ﴿٢٢﴾

33. Ata thanë: “Ne jemi të dërguar te një popull keqbërës.

قَالُوا إِنَّا أُرْسِلْنَا إِلَى قَوْمٍ  
مُجْرِمِينَ ﴿٢٣﴾

34. Që t'u hedhim atyre gurë prej dheu;

لِنُرْسِلَ عَلَيْهِمْ حِجَارَةً مِّنْ طِينٍ ﴿٣٤﴾

35. (gurë që) te Zoti yt janë të shënjuar për tejkaluesit e kufijve.”

مُسَوَّمَةٌ عِنْدَ رَبِّكَ لِلْمُسْرِفِينَ ﴿٣٥﴾

36. Atëherë Ne nxorëm prej atje të gjithë ata që ishin besimtarë.

فَأَخْرَجْنَا مَنْ كَانَ فِيهَا مِنَ الْمُؤْمِنِينَ ﴿٣٦﴾

37. Gjetëm vetëm një shtëpi me të nënshtruar.<sup>2</sup>

فَمَا وَجَدْنَا فِيهَا غَيْرَ بَيْتٍ مِّنَ الْمُسْلِمِينَ ﴿٣٧﴾

38. Lamë atje një shenjë për ata që i frikësohen ndëshkimit të dhimbshëm.

وَتَرَكْنَا فِيهَا آيَةً لِلَّذِينَ يَخَافُونَ الْعَذَابَ الْأَلِيمَ ﴿٣٨﴾

39. Edhe në (ngjarjen e) Musait (ka një shenjë), kur e dërguam te Faraoni me argument të qartë.

وَفِي مُوسَى إِذْ أَرْسَلْنَاهُ إِلَىٰ فِرْعَوْنَ بِسُلْطٰنٍ مُّبِينٍ ﴿٣٩﴾

40. (Faraoni) e ktheu shpinën, së bashku me parinë e tij, dhe tha: “Është magjistar ose i çmendur!”

فَتَوَلَّىٰ بِرُكْبَنِهِ وَكَانَ سِحْرًا مُّجْتَوًى ﴿٤٠﴾

41. Atëherë e kapëm atë dhe ushtritë e tij, i flakëm në det, dhe ai (vetë) ishte fajtor.

فَأَخَذْنَاهُ وَجُودَهُ فَنَبَذْنَاهُمْ فِي الْيَمِّ وَهُوَ مُلِيمٌ ﴿٤١﴾

42. Edhe në Ad (ka një shenjë), kur u dërguam atyre erën shkretuese.

وَفِي عَادٍ إِذْ أَرْسَلْنَا عَلَيْهِمُ الرِّيحَ الْعَقِيمَةَ ﴿٤٢﴾

43. Mbi çfarëdo që kalonte ajo, e rënonte duke e kthyer si të kalbur.

مَا تَذَرُ مِنْ شَيْءٍ أَتَتْ عَلَيْهِ إِلَّا جَعَلَتْهُ كَالرَّمِيمِ ﴿٤٣﴾

44. Edhe në Themud (ka një shenjë), kur atyre u ishte thënë: “Përfitoni deri në një kohë”.

وَفِي ثَمُودَ إِذْ قِيلَ لَهُمْ تَمَتَّعُوا حَتَّىٰ حِينٍ ﴿٤٤﴾

2. Muslimanë.

45. Dhe ata u rebeluan ndaj urdhrnit të Zotit të tyre, atëherë i zuri vetëtima dhe ata (e) shikonin të shastisur.

فَعَتَوْا عَنْ أَمْرِ رَبِّهِمْ فَأَخَذَتْهُمُ الضُّعْفَةُ  
وَهُمْ يَنْظُرُونَ ﴿٤٥﴾

46. Më nuk kishin fuqi as të ngriheshin, e as të hakmerreshin.

فَمَا اسْتَطَاعُوا مِنْ قِيَامٍ وَ مَا كَانُوا  
مُتَنَصِّرِينَ ﴿٤٦﴾

47. (Dhe) më parë, edhe në popullin e Nuhut (ka një shenjë). Ata ishin popull i pabindur.

وَقَوْمًا نُوْحٍ مِنْ قَبْلُ إِنَّهُمْ كَانُوا قَوْمًا  
فَاسِقِينَ ﴿٤٧﴾

48. Qiellin Ne e bëmë me fuqi të veçanta dhe, Ne jemi Zgjeruesit (e tij).<sup>3</sup>

وَالسَّمَاءَ بَنَيْنَاهَا بِأَيْدٍ وَإِنَّا لَمُوسِعُونَ ﴿٤٨﴾

49. Dhe tokën e hapëm, dhe sa Shtrues të mirë Jemi!

وَالْأَرْضَ فَرَشْنَاهَا فَنِعْمَ الْمُهَدُّونَ ﴿٤٩﴾

50. Dhe nga çdo gjë krijuam çifte, që të reflektoni.

وَمِنْ كُلِّ شَيْءٍ خَلَقْنَا زَوْجَيْنِ لَعَلَّكُمْ  
تَذَكَّرُونَ ﴿٥٠﴾

51. “Andaj, vraponi drejt Allahut; sigurisht, unë prej Tij jam për ju një alarmues i qartë.

فَفِرُّوْا إِلَى اللَّهِ ۖ إِنِّي لَكُمْ مِّنْهُ نَذِيرٌ  
مُّبِينٌ ﴿٥١﴾

52. Dhe mos i bëni të adhurueshëm tjetër Allahut; unë jam vërtet prej Tij, një alarmues i qartë për ju.”

وَلَا تَجْعَلُوا مَعَ اللَّهِ إِلَهًا آخَرَ ۖ إِنِّي لَكُمْ  
مِّنْهُ نَذِيرٌ مُّبِينٌ ﴿٥٢﴾

3. Fjala “duar” (arab. *ejd*), në arabisht nënkupton edhe fuqi. Andaj, një kuptim i ajetit është: “Ne e krijuam qiellin me disa fuqi të jashtëzakonshme”. Menjëherë pas kësaj, thotë “Ne jemi Zgjerues (të tij)”, deklaratë e cila provon që Kurani i Shenjtë është një mrekulli e Zotit të Madhërishtëm, sepse një Profet “i pashkolluar” i Arabisë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) vetë kurrë nuk mund ta bënte dot këtë zbulim shkencor, të cilin shkencëtarët, duke përdorur teknologji shumë të avancuar, do të arrinin ta zbulonin vetëm në kohët tona. Sot është e vërtetuar shkencërisht që universi po zgjerohet në çdo çast. Kurse në kohën e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, çdo njeri, pa përjashtim, e mendonte universin të palëvizshëm. Lexoni edhe 21:105.

53. Kështu, edhe ata që ishin më parë, sa herë që u erdhi ndonjë i dërguar, thanë: “Është magjistar ose i çmendur!”

كَذَلِكَ مَا آتَى الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ مِنْ  
رَسُولٍ إِلَّا قَالُوا سَاحِرٌ أَوْ مَجْنُونٌ ﴿٥٣﴾

54. A për këtë e këshillojnë njëri-tjetrin?! Në të vërtetë, janë një popull rebel.

أَتَوَاصُوا بِهٖ بَلْ هُمْ قَوْمٌ طَٰغَوْنَ ﴿٥٤﴾

55. Andaj, shmangu nga ata, e ti nuk do të kesh faj.

فَتَوَلَّ عَنْهُمْ فَمَا أَنْتَ بِمَلُومٍ ﴿٥٥﴾

56. Dhe këshillo, sepse këshilla patjetër u bën dobi besimtarëve.

وَذَكَرْ فَإِنَّ الذِّكْرَى تَنْفَعُ الْمُؤْمِنِينَ ﴿٥٦﴾

57. Unë i kam krijuar xhindët dhe njerëzit vetëm të Më adhurojnë.<sup>4</sup>

وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِلَّا  
لِيَعْبُدُونِ ﴿٥٧﴾

58. Nuk u kërkuj atyre ndonjë furnizim, e as nuk u kërkuj të Më ushqejnë.

مَا أُرِيدُ مِنْهُمْ مِنْ رِزْقٍ وَمَا أُرِيدُ أَنْ  
يُطْعَمُونِ ﴿٥٨﴾

59. Në të vërtetë Allahu është Furnizuesi, i Fuqishmi (dhe) i Forti.

إِنَّ اللَّهَ هُوَ الرَّزَّاقُ ذُو الْقُوَّةِ الْمَتِينُ ﴿٥٩﴾

60. Pa dyshim, ata që bënë të këqija, do të kenë të njëjtën pjesë, sikur pjesa e shokëve të tyre, prandaj, mos Më kërkoni (atë) me nxitim.

فَإِنَّ لِلَّذِينَ ظَلَمُوا ذُنُوبًا مِثْلَ ذُنُوبِ  
أَصْحَابِهِمْ فَلَا يَسْتَعْجِلُونَ ﴿٦٠﴾

61. Pra, u mjerofshin ata që mohuan në ditën e tyre që u është premtuar.

فَوَيْلٌ لِلَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ يَوْمِهِمُ الَّذِي  
يُوعَدُونَ ﴿٦١﴾

4. Fjalët “xhindët dhe njerëzit” në këtë ajet nënkuptojnë njerëzit e fortë dhe të dobët, popujt e fuqishëm dhe të dobët. Allahu i Madhërishëm të dyve u ka përcaktuar adhurimin e Tij si qëllim të krijimit të tyre. Me fjalën “xhindët” nëse marrim vetëm kuptimin e përfolur, pra, krijesa të mbinatyrshe, do të na duhet të besojmë se edhe ata do të shpërblehen për adhurimin që i bëjnë Zotit. Me fjalë të tjera, edhe ata duhet të kenë më vete sihariqin se do të shkojnë në xhenet. Por Kurani i Shenjtë në asnjë ajet nuk përmend ndonjë xhenet për xhindët. Lexoni edhe 6:129.

## Surja 52 – Et-Tur

Surja Et-Tur është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka pesëdhjetë ajete.

Edhe kjo sure fillon me disa dëshmi qiellore. Më së pari është sjellë si dëshmitar mali Tur, në të cilin *Hazret* Musai<sup>as</sup> mori profecinë e ardhjes së Profetit më madhështor, pra të Profetit Muhammed<sup>savs</sup>. Më pas u betua për një Libër të shkruar mbi lëkura. Ngaqë në lashtësi librat shkruheshin mbi lëkura, edhe këtu, Libri qiellor është paraqitur si i shkruar nëpër to. Pikërisht në këtë Libër vjen edhe profecia për Shtëpinë e Allahut, që do të mbushet me njerëz të devotshëm dhe plot spiritualitet. Edhe një herë tjetër është betuar për qiellin si një çati shumë e lartë, gjithashtu edhe për detin me plot dallgë. Mes këtyre dyve është edhe uji që për jetën bëhet bazë.

Pas të gjitha këtyre dëshmime qiellore, Allahu i Madhërisëm i paralajmëron mohuesit që ditën kur qielli do të lëkundet, do të flaken tutje superfuqitë e botës që janë porsimale, dhe kështu, që në këtë botë ato do të pësojnë një shkatërrim të madh.

Më pas, keqbërësve u është premtuar xhehenemi dhe atyre që patën druajtje ndaj Zotit u është dhënë lajmi i mirë i xhenetit. Duke e porositur Profetin Muhammed<sup>savs</sup> që vazhdimisht t'i këshillojë njerëzit, Allahu i Madhërisëm thotë:

O Profet! As ti nuk je i çmendur, e as fjalët e tua nuk janë fjalë fallxhori, sepse edhe fjalët e tua, edhe shpallja që të vjen ty e hedhin poshtë këtë ide. Prandaj, duro për hir të Zotit dhe për hir të detyrës për ta përhapur urdhrin e Zotit tënd. Ti je para Syve Tanë, pra je gjithmonë nën mbrojtjen Tonë. Vazhdo ta përkujtosh Allahun duke përmendur lavdërimin e Tij, qoftë në adhurimin që bën gjatë ditës, qoftë kur ngrihesh për adhurim gjatë natës, po kështu, ji i angazhuar në adhurim edhe kur yjet të kenë perënduar.



- |                                                              |                                         |
|--------------------------------------------------------------|-----------------------------------------|
| 1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit. | بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ① |
| 2. Beto hem për Turin! <sup>1</sup>                          | وَ الطُّورِ ①                           |
| 3. Dhe për Librin e shkruar,                                 | وَ كِتَابٍ مَّسْطُورٍ ①                 |
| 4. në lëkura të hapura!                                      | فِي رَقٍ مَّنشُورٍ ①                    |
| 5. Dhe për Shtëpinë e populluar! <sup>2</sup>                | وَ الْبَيْتِ الْمَعْمُورِ ①             |
| 6. Dhe për çatinë e ngritur! <sup>3</sup>                    | وَ السَّقْفِ الْمَرْفُوعِ ①             |
| 7. Dhe për detin e dallgëzuar! <sup>4</sup>                  | وَ الْبَحْرِ الْمَسْجُورِ ①             |
| 8. Pa dyshim, ndëshkimi i Zotit tënd do të bjerë.            | إِنَّ عَذَابَ رَبِّكَ لَوَاقِعٌ ①       |
| 9. Kush që e largon nuk ka.                                  | مَا لَهُ مِنْ دَافِعٍ ①                 |
| 10. Ditën kur qielli do të tronditet fort.                   | يَوْمَ تَمُورُ السَّمَاءُ مَورًا ①      |
| 11. Dhe malet do të lëvizin me shpejtësi.                    | وَ تَسِيرُ الْجِبَالُ سَيْرًا ①         |

1. Për të kuptuar filozofinë dhe rëndësinë e betimeve të Zotit, lexoni 37:2.

2. Nënkupton Xhaminë e Jerusalemit ose Qaben, ose ndonjë shtëpi të shenjtë adhurimi. Qabja e Shenjtë përshkruhet me cilësi të ndryshme në Kuran, si “vend tubimi dhe paqeje për njerëzit” (2:126), “Shtëpia e Shenjtë” (5:3), “Xhamia e Shenjtë” (17:2), “Shtëpia e lashtë” (22:30), dhe “Qyteti i paqes” (95:4) etj..

3. Me çatinë e ngritur mund të nënkuptohet tabernakulli ose çadra që Moisiu (*Hazret Musai*<sup>as</sup>) kishte ngritur jashtë kampit të izraelitëve, ku adhuronte Zotin e Madhërishëm (Eksodi 33:7); ose Qabeja; ose qielli.

4. Me detin e dallgëzuar mund të nënkuptohet deti ku Faraoni dhe ushtritë e tij të fuqishme u mbytën tek sa po i ndiqnin *Hazret Musain*<sup>as</sup> dhe bijtë e Izraelit; ose çdo det tjetër kur është i dallgëzuar.

12. U mjerofshin atë ditë mohuesit!

فَوَيْلٌ لِلْيَوْمِيَّةِ لِلْمَكْذِبِينَ ﴿١٢﴾

13. Të cilët rrinë duke argëtuar në kotësi.

الَّذِينَ هُمْ فِي حَوْصٍ يَلْعَبُونَ ﴿١٣﴾

14. Ditën kur ata do të shtyhen fort drejt zjarrit të xhehenemit.

يَوْمَ يُدْعَوْنَ إِلَىٰ نَارِ جَهَنَّمَ دَعَاً ﴿١٤﴾

15. “Ky është zjarri që ju e mohonit!”

هَذِهِ النَّارُ الَّتِي كُنْتُمْ بِهَا تَكْذِبُونَ ﴿١٥﴾

16. Pra, magji qenka kjo apo ju nuk shihni qartë?!

أَفَسِحْرٌ هَذَا أَمْ أَنْتُمْ لَا تُبْصِرُونَ ﴿١٦﴾

17. Hyni në të! Në daç të duroni ose të mos duroni; njësoj është për ju. Ju jeni “shpërblyer” vetëm për ato që keni bërë.”

إِصْلَوْهَا فَاصْبِرُوا أَوْ لَا تَصْبِرُوا سَوَاءٌ

عَلَيْكُمْ ۗ إِنَّمَا تُجْرَوْنَ مَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ ﴿١٧﴾

18. Pa dyshim, të druajturit (ndaj Zotit) do të jenë në xhenete e në bekime.

إِنَّ الْمُتَّقِينَ فِي جَنَّاتٍ وَنَعِيمٍ ﴿١٨﴾

19. Të gëzuar për atë që Zoti i tyre do t’ua dhurojë, dhe Zoti i tyre do t’i shpëtojë ata nga ndëshkimi i xhehenemit.

فَكِهِينَ بِمَا آتَاهُم رَبُّهُمْ ۗ وَوَقَّاهُمْ

رَبُّهُمْ عَذَابَ الْجَحِيمِ ﴿١٩﴾

20. “Hani e pini hareshëm për shkak të asaj që keni bërë.”

كُلُوا وَاشْرَبُوا هَنِيئًا بِمَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ ﴿٢٠﴾

21. Do të jenë të mbështetur nëpër frone të rreshtuara, dhe do t’u japim si bashkëshorte hyri symëdha.

مُتَّكِنِينَ عَلَىٰ سُرُرٍ مَّصْفُوفَةٍ ۗ وَزَوَّجَهُم

بِحُورٍ عِينٍ ﴿٢١﴾

22. Dhe ata që besuan dhe, edhe fëmijët e tyre i ndoqën në besim, Ne do t’i bashkojmë me fëmijët e tyre, ndërkohë që nuk do t’ua pakësojmë veprat aspak. Çdo njeri është peng i asaj që ka punuar.

وَ الَّذِينَ آمَنُوا وَاتَّبَعَتْهُمْ ذُرِّيَّتُهُمْ

بِإِيمَانٍ الْحَقْنَابَهُمْ ذُرِّيَّتَهُمْ وَمَا آتَاهُمْ

مَنْ عَمَلِهِمْ مِنْ شَيْءٍ ۗ كُلُّ امْرِئٍ بِمَا

كَسَبَ رَهِيْنٌ ﴿٢٢﴾



23. Ne do t'i ndihmojmë ata (dhe do t'u japim) një frutë e një mish (të atillë) që ata do ta pëlqejnë.

وَأَمْدَدْنَاهُمْ بِفَاكِهَةٍ وَرَحِمٍ مِّمَّا يَشْتَهُونَ ﴿٢٣﴾

24. Atje do t'i "rrëmbejnë" kupa njëri-tjetrit, (mirëpo) atje nuk do të ketë as kotësi, as mëkat.

يَتَنَزَّعُونَ فِيهَا كَأَسَا لَا نَعُو فِيهَا  
وَلَا تَأْتِيهِمْ ﴿٢٤﴾

25. Djemtë e rinj të tyre, që do të jenë porsì perla të mbuluara, do të sillen rreth tyre.<sup>5</sup>

وَيَطُوفُ عَلَيْهِمْ غِلْمَانٌ لَهُمْ كَأَنَّهُمْ  
لُؤْلُؤًا مَّكْنُونٌ ﴿٢٥﴾

26. Do të dalin përpara njëri-tjetrit dhe do të pyesin për njëri-tjetrin.

وَأَقْبَلَ بَعْضُهُمْ عَلَى بَعْضٍ يَتَسَاءَلُونَ ﴿٢٦﴾

27. Do të thonë: "Pa dyshim, përpara kësaj kemi qenë të trembur në familjet tona.

قَالُوا إِنَّا كُنَّا قَبْلَ فِي أَهْلِنَا مُشْفِقِينَ ﴿٢٧﴾

28. Allahu na bëri mirësi dhe na shpëtoi nga ndëshkimi përcëllues.

فَمَنَّ اللَّهُ عَلَيْنَا وَوَقَدْنَا عَدَابَ السُّمُومِ ﴿٢٨﴾

29. Sigurisht, ne edhe më parë Atij i luteshim (dhe) pikërisht, Ai është Mirëbërësi, Mëshirëbërësi."

إِنَّا كُنَّا مِنْ قَبْلُ نَدْعُوهُ ۗ إِنَّهُ هُوَ الْبَرُّ  
الرَّحِيمُ ﴿٢٩﴾

30. Andaj, këshillo! Falë bekimit të Zotit tënd, ti nuk je as fallxhor e as i çmendur.

فَذَكِّرْ فَمَا أَنْتَ بِنِعْمَتِ رَبِّكَ بِكَاهِنٍ  
وَلَا مَجْنُونٍ ﴿٣٠﴾

31. A thonë: "(Ky) është poet për të cilin presim fatkeqësitë e kohës"?!

أَمْ يَقُولُونَ شَاعِرٌ نَّتَرَبَّصُّ بِهِ رَيْبَ  
الْمُنُونِ ﴿٣١﴾

5. Edhe ky ajet përshkruan bekimet e xhenetit në një gjuhë të figurshme. Në shërbim të xhenetlinjve do të jenë djemtë që do të jenë "porsì perla të mbuluara". Këto fjalë tregojnë hapët se i gjithë ky ligjërim është plot me fjalë të figurshme. Zoti thotë "djemtë e rinj", që mund të jenë vetë fëmijët e xhenetlinjve, të cilët do të qëndrojnë pranë dhe do t'u shërbejnë atyre. Në xhenet, njerëzit nuk do të vuajnë nga largimi i fëmijëve sepse nuk do t'u mungojnë asnjëherë. Këtu Zoti ka përdorur fjalën "gilman" (djemtë e rinj), por në ajete të tjera të ngjashme si ky, ka përdorur fjalën "vildan" (56:18 dhe 76:20), që është shumësi i fjalës "veled", që do të thotë bir.

32. Thuaj: “Prisni, se edhe unë po pres bashkë me ju!”

قُلْ تَرَبَّصُوا فَإِنِّي مَعَكُمْ مِّنَ  
الْمُتَرَبِّصِينَ ۝٣٢

33. I urdhëruaka mendja e tyre për këto, apo janë një popull rebel?!

أَمْ تَأْمُرُهُمْ أَحْلَامُهُمْ بِهَذَا أَمْ هُمْ قَوْمٌ  
طَاغُونَ ۝٣٣

34. A thonë: “E ka sajuar ai vetë”? Jo, në të vërtetë, ata nuk besojnë.

أَمْ يَقُولُونَ تَقَوَّلَهُ ۚ بَلْ لَا يُؤْمِنُونَ ۝٣٤

35. Atëherë le të sjellin një vepër të ngjashme si kjo, në qoftë se thonë të vërtetën.

فَلْيَأْتُوا بِحَدِيثٍ مِّثْلِهِ إِن كَانُوا صَادِقِينَ ۝٣٥

36. A u krijuan (vetvetiu) pa asgjë, apo janë ata krijuesit?!

أَمْ خُلِقُوا مِنْ غَيْرِ شَيْءٍ أَمْ هُمْ  
الْخَالِقُونَ ۝٣٦

37. A krijuan ata qiejt e tokën?! Jo, në të vërtetë, ata nuk binden.

أَمْ خَلَقُوا السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ ۚ بَلْ لَا  
يُوقِنُونَ ۝٣٧

38. A zotërojnë thesaret e Zotit tënd, apo janë rojtarë (mbi to)?!

أَمْ عِنْدَهُمْ خَزَائِنُ رَبِّكَ أَمْ هُمْ  
الْمُضْطَرُّونَ ۝٣٨

39. A kanë ndonjë shkallë, (duke hipur) në të cilën dëgjojnë fjalët?! Atëherë dëgjuesi i tyre duhet të sjellë ndonjë argument të qartë.

أَمْ لَهُمْ سُلَّمٌ يَّرْتَمِعُونَ فِيهَا فَلْيَأْتِ  
مُسْتَمِعَهُمْ بِسُلْطَنِ مُّبِينٍ ۝٣٩

40. A për Të qenkan bijat, kurse për ta djemtë?!

أَمْ لَهُ الْبَنَاتُ وَلَكُمْ الْبَنُونَ ۝٤٠

41. A u ke kërkuar ndonjë shpërblim, që ata të jenë të rënduar nga barra?!

أَمْ تَسْأَلُهُمْ أَجْرًا فَهُمْ مِنْ مَّعْرُومٍ  
مُّثْقَلُونَ ۝٤١

42. A zotëruakan të padukshmen, që po e shkruajnë?!

أَمْ عِنْدَهُمُ الْعِيبُ فَهُمْ يَكْتُمُونَ ۝٤٢

43. Apo duan të bëjnë kurth?!  
Atëherë (ta dinë), ata që mohuan,  
kundër tyre do të bëhet kurthi.

أَمْ يَرِيدُونَ كَيْدًا ۖ فَالَّذِينَ كَفَرُوا هُمُ  
الْمَكِيدُونَ ﴿٤٣﴾

44. A kanë të adhurueshëm tjetër  
përveç Allahut?! I Pastër është Allahu  
nga gjithçka që ata bëjnë ortak me  
Të.

أَمْ لَهُمْ آلِهَةٌ غَيْرُ اللَّهِ ۖ سُبْحَانَ اللَّهِ عَمَّا  
يُشْرِكُونَ ﴿٤٤﴾

45. E nëse shohin ndonjë copë  
prej qiellit duke rënë, do të thonë:  
“Qenkan re të dendura!”

وَإِنْ يَرَوْا كِسْفًا مِّنَ السَّمَاءِ سَاقِطًا  
يَقُولُوا سَحَابٌ مَّرْكُومٌ ﴿٤٥﴾

46. Andaj, lëri ata, derisa ta shohin  
ditën e tyre, në të cilën do t’u bjerë  
vetëtima.

فَذَرَهُمْ حَتَّىٰ يَأْتِيَوا يَوْمَهُمُ الَّذِي فِيهِ  
يُصْعَقُونَ ﴿٤٦﴾

47. Ditën kur kurthi i tyre nuk do t’i  
shpëtojë dot aspak dhe as nuk do të  
ndihmohen.

يَوْمَ لَا يُغْنِي عَنْهُمْ كَيْدُهُمْ شَيْئًا  
وَلَا هُمْ يُنصَرُونَ ﴿٤٧﴾

48. Dhe, sigurisht, për ata që bënë  
të këqija, do të ketë ndëshkim shtesë  
përveç kësaj, por shumica e tyre nuk  
dinë.

وَإِنَّ لِلَّذِينَ ظَلَمُوا عَذَابًا دُونَ ذَلِكَ  
وَلَكِنَّ أَكْثَرَهُمْ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٤٨﴾

49. Duro për urdhrin e Zotit tënd,  
se ti je para Syve Tanë, dhe përkujto  
Zotin tënd me lavdërimin e Tij kur  
ngrihesh;

وَاصْبِرْ لِحُكْمِ رَبِّكَ فَإِنَّكَ بِأَعْيُنِنَا وَسَبِّحْ  
بِحَمْدِ رَبِّكَ حِينَ تَقُومُ ﴿٤٩﴾

50. edhe gjatë natës përkujtoje Atë,  
edhe pasi yjet perëndojnë.

وَمِنَ اللَّيْلِ فَسَبِّحْهُ وَإِدْبَارَ النُّجُومِ ﴿٥٠﴾

## Surja 53 – En-Nexhm

Surja En-Nexhm u zbrit menjëherë pas mërgimit në Abisini (Etiopi), në vitin e pestë pas profetërisë. Bashkë me bismil-lahin, ajo ka gjashtëdhjetë e tri ajete.

Kjo sure quhet En-Nexhm, që përkthehet “Ylli”. Fjalët e fundit të sures paraardhëse ishin: “*pasi yjet perëndojnë*”. Pas kësaj, këtu flitet për idhujtarët dhe për yllin, të cilin ata e adhuronin. Po kështu, kjo sure bën profeci se ylli i tyre do të rrëzohet dhe thotë – ky parashikim nuk është trillim i Profetit Muhammed, pasi ai kurrë nuk flet nga vetja.

Në suren Edh-Dharijat, që është një nga suret paraardhëse, u tha që Allahu është *i Fuqishmi*, *i Forti* (arab. *Dhul-kuvvetil-metin*), gjithashtu edhe *Furnizuesi ose Dhënësi* (arab. *Err-Rrezzak*). Duke e përshkruar pikërisht Allahun, kjo sure thotë se Ai është *Zotëruesi i Fuqive të mëdha* (arab. *Shedidul-kuva*) dhe *Zotëruesi i Urtësisë së pashoqe* (arab. *Dhu mirretin*).

Pas kësaj, përmendet ngjarja e *Miraxhit*. [Në përkthimin e ajetit nr. 9 të kësaj sureje, veprimet “u afrua” dhe “u zbrit” i janë referuar Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, dhe komentimin e tij sipas përkthimit të dhënë, mund ta lexoni në komentin nën ajetin nr. 10. Por, këto veprime shpjegohen edhe në një mënyrë tjetër, ku folja e parë i referohet Profetit<sup>savs</sup>, dhe e dyta Zotit të Madhërisëm. Në këtë rast, shpjegimi i ajetit është sa vijon. shn.përkth]. Profeti Muhammed<sup>savs</sup> u ngjit e iu afrua Zotit të tij dhe Zoti i Madhërisëm u zbrit me mëshirë mbi të, dhe Profeti<sup>savs</sup> u bë si korda midis dy harqeve. Këto janë ajete të vështira, dhe komentues të ndryshëm janë përpjekur të japin shpjegime të ndryshme. Por ajo që është e qartë që në këtë ngjarje nuk bëhet fjalë për ndonjë qiell fizik, por një përjetim krejt të jashtëzakonshëm që u bë në zemrën e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>. Ky ishte një *keshf*, të cilit nuk mund t’i gjejmë dot shembullin te asnjë Profet tjetër. Zemra e tij, e dashuruar me Allahun, u ngjit në lartësitë qiellore, dhe Allahu, i Dashuruar me robin e Tij, u zbrit mbi zemrën e Muhammedit<sup>savs</sup>.

*Korda mes dy harqeve* do të thotë se Profeti<sup>savs</sup> u bë ajo korda e vetme që gjendej mes harkut të tij dhe harkut të Zotit të Madhërisëm. Me fjalë të tjera, shigjeta që lëshohet nga harku i Zotit të Madhërisëm ishte pikërisht ajo që lëshohet nga harku i Profetit Muhammed<sup>savs</sup>. Ky *tefsir* (komentim) i këtij ajeti të Kuranit të Shenjtë është i saktë, sepse përkon edhe me një ajet tjetër të tij, në të cilin Allahu i Madhërisëm thotë: “... dhe (o Muhammed!) kur ti gjuajte gurë (në drejtim të tyre), nuk i gjuajte ti, por i gjuajti Allahu.” (8:18)

Në vijim, një tjetër ajet tregon një fakt, i cili njëherësh, është argument vendimtar për të provuar se udhëtimi i *Miraxhit* nuk ishte fizik. Ajeti në fjalë thotë: “Zemra nuk gënjeu atë që pa”.

Pra, është e qartë që jo sytë truporë të Profetit<sup>savs</sup>, por sytë e tij të zemrës e panë

Allahun e Madhërishëm dhe nuk gënjyen në atë që panë.

Më pas përmendet “*Sidretul-Munteha*”, pra një *hide e skajshme*, e cila nënkupton kufirin ndarës të skajit njerëzor, aty ku fillon pozita e lartë e Allahut të Madhërishëm, që krijesat nuk e prekin dot. Në fakt, arabët e kanë pasur si traditë edhe më parë, dhe e kanë edhe sot, që pronari i tokës vë hide me gjemba për ta rrethuar tokën e tij dhe njëkohësisht për të treguar edhe skajet e pronës së tij. Shkurt, në qiell askund nuk kishte ndonjë hide fizike, me demek që Profeti Muhammed<sup>savs</sup> nuk kishte mundësi ta kapërcente dot atë. Një komentim i tillë i këtyre ajeteve është qesharak, komentim i cili u fut nëpër literaturë gjatë Mesjetës. Kuptimi i hides edhe këtu është që Profeti Muhammed<sup>savs</sup> arriti lartësitë shpirtërore deri në atë pozitë, që asnjë rob nuk mund të shkojë dot përtej saj, sepse më andej, fillojnë atributet *tenzihije* (ekskluzive) të Allahut të Madhërishëm.

Pas kësaj, duke folur për zotat e rremë, Allahu i Madhërishëm thotë se idhujtarët nuk kanë asnjë argument të ekzistencës së tyre, përkundrazi, ndjekin vetëm fiksime.

Këtu emri *She'ra* i referohet pikërisht atij ylli (Siriusi), të cilin idhujtarët e kishin marrë për Zot.

Më pas, shkurtimisht përmenden disa popuj idhujtarë, sesi ata u katandisën në ndëshkime për shkak të idhujtarisë së tyre.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Beto hem për yllin kur do të bjerë!

وَالنَّجْمِ إِذَا هَوَىٰ ①

3. Shoku juaj as nuk devijoi e as nuk dështoi.

مَا ضَلَّ صَاحِبُكُمْ وَمَا غَوَىٰ ①

4. Ai nuk flet nga dëshira vetjake.

وَمَا يَنْطِقُ عَنِ الْهَوَىٰ ①

5. Kjo është vetëm shpallje që shpallet;

إِنْ هُوَ إِلَّا وَحْيٌ يُوحَىٰ ①

6. atë e mësoi Zotëruesi i fuqive të mëdha,

عَلَّمَهُ شَدِيدُ الْقُوَىٰ ①

7. Zotëruesi i urtësisë. Pra, u vendos (në Arsh për ekzekutimin e fuqive të Tij).

ذُو مِرَّةٍ فَاسْتَوَىٰ ①

8. Ndërkohë ai ishte në horizontin më të lartë.

وَهُوَ بِالْأُفُقِ الْأَعْلَىٰ ①

9. Pas kësaj, u afrua (me Zotin), dhe u zbrit (pranë njerëzve).

ثُمَّ دَنَا فَتَدَلَّىٰ ①

10. Dhe ai u bë si korda e dy harqeve, ose edhe më afër.<sup>1</sup>

فَكَانَ قَابَ قَوْسَيْنِ أَوْ أَدْنَىٰ ①

1. Një komentim i këtyre ajeteve është përmendur në parathënien e sures. Por këto ajete kanë edhe një domethënie tjetër. Këtu *afirm* (arab. *dena* ose *denvun*) do të thotë afrimi i Profetit Muhammed<sup>savs</sup> me Zotin. Afrimi me Zotin nuk nënkupton lëvizjen fizike. Afrimi i njeriut me Zotin bëhet atëherë kur robi lirohet nga dëshirat e veta, nga *nefsi* i vet dhe nga çfarëdo e kushdo tjetër përveç Zotit, dhe kridhet në nënshtrimin dhe në dashurinë ndaj Tij. Pra, ai zhytet në oqeanin e dashurisë së Zotit në atë mënyrë që të mos ketë më me vete asnjë ndikim personal dhe ai i gjithi dorëzohet nën kontrollin e Zotit. Në këtë pozicion, atributet e Zotit manifestohen në zemrën e pastër të robit. Pas kësaj, fillon një proces tjetër në qenien e robit,

11. Atëherë (Zoti) i shpalli robit të Tij atë që do ta shpallte. فَأَوْحَىٰ إِلَىٰ عَبْدِهِ مَا أَوْحَىٰ ۖ
12. Zemra nuk gënjeu atë që pa. مَا كَذَّبَ الْفُؤَادُ مَا رَأَىٰ ۖ
13. A po dyshoni në atë që ai e pa?! أَفَتُكْمِرُونَهُ عَلَىٰ مَا يَرَىٰ ۖ
14. Kurse ai e ka parë këtë edhe në një herë tjetër. وَلَقَدْ رَآهُ نَزْلَةً أُخْرَىٰ ۖ
15. Pranë hides së tejskajshme. عِنْدَ سِدْرَةِ الْمُنْتَهَىٰ ۖ
16. Pranë saj është xheneti strehues. عِنْدَهَا جَنَّةُ الْمَأْوَىٰ ۖ
17. Kur ajo që mbulon,<sup>2</sup> e mbuloi hiden. إِذْ يُخَشَى السِّدْرَةَ مَا يُخَشَىٰ ۖ
18. Shikimi as nuk pati shtrembërim, as nuk e teproi.<sup>3</sup> مَا زَاغَ الْبَصَرُ وَمَا طَغَىٰ ۖ

që përmendet në fjalën vijuese “*tedel-le*” e që do të thotë “ai zbriti poshtë”. Kjo zbritje e Profetit Muhammed<sup>savs</sup> nënkupton kthimin e tij te krijesat, por të praruar me atributet Hyjnore, me dhembshurinë dhe mëshirën Hyjnore. Sa më i përsosur të jetë procesi i afrimit me Zotin, aq më e plotë është edhe zbritja te krijesat e Tij. Kjo zbritje e bën robin, pra Profetin, edhe Kalif (mëkëmbës) të Allahut dhe po kjo është ajo që thotë Zoti “fryj në të prej Shpirtit Tim”. Andaj, Profeti Muhammed<sup>savs</sup> si njeriu i përsosur, së pari iu afrua Zotit në mënyrë të përsosur, e më pas iu drejtua njerëzimit në mënyrë të përsosur. Kjo si pamje, në ajetin nr. 10, është paraqitur përmes dy harqeve. Harku i sipërm është ai i Zotit, kurse harku i poshtëm është i krijesave, pra i njerëzve. Duke krijuar kontakt me të dyja harqet, ai bëhet vija e mesme që i ndan ato. Pas afrimit me Zotin, ai kthehet te krijesat, për arsye se afrimi i mëtejshëm me Zotin është i lidhur me shërbimin e krijesave. Shkurt, ngaqë Profeti Muhammed<sup>savs</sup> u përsos në dashurinë ndaj Zotit dhe iu afrua përsosmërisht Atij, më pas, po në këtë masë iu afrua njerëzimit, ai u bë vija e mesme mes dy harqeve. Kjo pikërisht i siguroi prej Zotit edhe të drejtën për *ndërmjetësimin* dhe ai u quajt *ndërmjetësues* (arab. *shafi*).

2. Nënkuptohet shfaqja ose manifestimi i Allahut të Madhërishëm.

3. Ajetet 8-18 përshkruajnë *Miraxhin* ose udhëtimin shpirtëror të Profetit<sup>savs</sup> në lartësitë qiellore, ku atij do t'i bëhej manifestim tejet i qartë i Zotit Urtiplohtë. Shumë njerëz shpesh e ngatërrojnë udhëtimin e *Miraxhit* me udhëtimin e *Israsë*. Të dyja udhëtimet janë të ndryshme. Udhëtimi i *Miraxhit* ka ndodhur në vitin e 5-të të profetërisë, pas mërgimit të muslimanëve në Abisini (Etiopi), kurse udhëtimi i *Israsë* që ishte një udhëtim shpirtëror nga Meka në Jerusalemin, ndodhi në vitin e 11-të ose e 12-të të profetërisë, pak para mërgimit në Medinë (Hixhreti). Për këtë arsye, të dyja udhëtimet janë përmendur në sure të ndryshme, konkretisht udhëtimi i *Israsë* në suren 17 që quhet Beni Israil ose Isra, kurse ai i *Miraxhit* në këtë sure.

19. Pa dyshim, ai pa një ndër shenjzat më të mëdha të Zotit të tij.

لَقَدْ رَأَى مِنْ آيَاتِ رَبِّهِ الْكُبْرَى ﴿١٩﴾

20. A keni parë Latën dhe Uzzanë?

أَفَرَأَيْتُمُ اللَّتَّ وَالْعُزَّىٰ ﴿٢٠﴾

21. Edhe tjetrën, Menatën (pra), të tretën?

وَمَنْوَةَ الثَّالِثَةِ الْآخْرَىٰ ﴿٢١﴾

22. “Vallë, për ju paska djem dhe për Të paska vajza?!”

أَلَكُمُ الذَّكَرُ وَلَهُ الْأُنثَىٰ ﴿٢٢﴾

23. E po kjo qenka një ndarje e padrejtë!

تِلْكَ إِذَا قَسَمَةً ضَيَّرَىٰ ﴿٢٣﴾

24. Këta janë vetëm emra që i keni emërtuar ju dhe baballarët tuaj; Allahu nuk zbriti asnjë argument për ta.” Ata e ndjekin vetëm hamendjen, si dhe atë që u thotë vetja. Ndërkohë, u ka ardhur udhëzimi prej Zotit të tyre.

إِنَّ هِيَ إِلَّا أَسْمَاءٌ سَمَّيْتُمُوهَا أَنْتُمْ  
وَأَبَاؤُكُمْ مَا أَنْزَلَ اللَّهُ بِهَا مِنْ سُلْطَانٍ ۗ  
إِنْ يَتَّبِعُونَ إِلَّا الظَّنَّ وَمَا تَهْوَى  
الْأَنْفُسُ ۗ وَلَقَدْ جَاءَهُمْ مِنْ رَبِّهِمْ  
الْهُدَىٰ ﴿٢٤﴾

25. A gjen njeriu çdo gjë që dëshiron?!

أَمْ لِلْإِنْسَانِ مَا تَمَنَّىٰ ﴿٢٥﴾

26. Të Allahut janë edhe fundi, edhe fillimi.

بَلَىٰ ۗ فَبِاللهِ الْآخِرَةُ وَالْأُولَىٰ ﴿٢٦﴾

27. Dhe sa shumë engjëj ka nëpër qiej, që ndërmjetësimi i tyre nuk vlen për asgjë, përveçse pasi Allahu të urdhërojë për ndokënd, për të cilin Ai dëshiron dhe pëlqen!

وَكَمْ مِنْ مَلَكٍ فِي السَّمَوَاتِ لَا تُغْنِي  
شَفَاعَتُهُمْ شَيْئًا إِلَّا مِنْ بَعْدِ أَنْ يَأْذَنَ  
اللَّهُ لِمَنْ يَشَاءُ وَيَرْضَىٰ ﴿٢٧﴾

28. Pa dyshim, ata që nuk besojnë në *ahiret*, i emërtojnë engjëjt me emra femrash.

إِنَّ الَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ بِالْآخِرَةِ لَيُسَمُّونَ  
الْمَلَائِكَةَ تَسْمِيَةَ الْأُنثَىٰ ﴿٢٨﴾



29. Ndërkohë që ata nuk kanë aspak dije për këtë. Ndjekin vetëm hamendjen. Dhe hamendja nuk vlen për asgjë përpara së vërtetës.

30. Andaj, shmang atë që ia ktheu shpinën përkujtimit Tonë dhe që nuk deshi asgjë përveç jetës së kësaj bote.

31. Kjo është e gjithë arritja e dijes së tyre. Pikërisht Zoti yt e di atë që devijoi nga rruga e Tij, dhe pikërisht Ai e di atë që u udhëzua.

32. E Allahut është gjithçka që është në qiej dhe gjithçka që është në tokë, që ata të cilët bënë të këqija, Ai t'i ndëshkojë për veprat e tyre, dhe t'i shpërblejë në mënyrën më të mirë ata që bënë të mira;

33. ata të cilët ruhen nga mëkatet e mëdha dhe nga imoraliteti, përveç lajthitjeve të vogla. Sigurisht, Zoti yt ka falje të gjerë; Ai ju di më së miri kur ju rriti prej tokës dhe kur ju ishit embrione në barqet e nënave tuaja. Andaj, mos e quani veten të pastër; Ai e di më së miri se kush i druhet (Atij).

34. A ke menduar për atë që e ktheu shpinën,

35. dha pak e (pastaj) u tërhoq?

36. A ka ai dijen e së padukshmes, të cilën e shikuaka?!

وَمَا لَهُمْ بِهِ مِنْ عِلْمٍ ۖ إِنْ يَتَّبِعُونَ إِلَّا الظَّنَّ ۗ وَ إِنْ الظَّنُّ لَا يُعْزِي مِنَ الْحَقِّ شَيْئًا ۝

فَاعْرُضْ عَنْ مَنْ تَوَلَّىٰ عَنْ ذِكْرِنَا وَلَمْ يُرِدْ إِلَّا الْحَيَاةَ الدُّنْيَا ۝

ذَلِكَ مَبْلَغُهُمْ مِنَ الْعِلْمِ ۗ إِنَّ رَبَّكَ هُوَ أَعْلَمُ بِمَنْ ضَلَّ عَنْ سَبِيلِهِ ۗ وَهُوَ أَعْلَمُ بِمَنْ اهْتَدَىٰ ۝

وَاللَّهُ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ لِيَجْزِيَ الَّذِينَ أَسَاءُوا بِمَا عَمِلُوا وَيَجْزِيَ الَّذِينَ أَحْسَنُوا بِالْحُسْنَىٰ ۝

الَّذِينَ يَجْتَنِبُونَ كَبِيرَ الْإِثْمِ وَالْفَوَاحِشَ إِلَّا اللَّمَمَ ۗ إِنْ رَبَّكَ وَاسِعُ الْمَغْفِرَةِ ۗ هُوَ أَعْلَمُ بِكُمْ إِذْ أَنْشَأَكُمْ مِنَ الْأَرْضِ وَإِذْ أَنْتُمْ أَجِنَّةٌ فِي بُطُونِ أُمَّهَاتِكُمْ ۗ فَلَا تُزَكُّوْا أَنْفُسَكُمْ ۗ هُوَ أَعْلَمُ بِمَنِ اتَّقَىٰ ۝

أَفَرَأَيْتَ الَّذِي تَوَلَّىٰ ۝

وَ أَعْطَىٰ قَلِيلًا وَ أَاكْدَىٰ ۝

أَعْدَهُ عِلْمُ الْعَيْبِ فَهُوَ يَرَىٰ ۝

37. A nuk u vu në dijeni për atë që është në skriptet e Musait,

أَمْ لَمْ يُنَبَّأْ بِمَا فِي صُحُفِ مُوسَىٰ ۙ

38. dhe në (ato) të Ibrahimit që përmbushi premtimin?!

وَأَبْرَاهِيمَ الَّذِي وَفَّىٰ ۙ

39. Se asnjë mbartës nuk do të mbajë barrën e tjetrit;

أَلَّا تَرَىٰٓ ذُرًّا وَّزُرَّةً ۙ وَذُرًّا آخَرَ ۙ

40. dhe se njeriu nuk do të ketë asgjë përveç përpjekjes së tij;<sup>4</sup>

وَأَنْ لَّيْسَ لِلْإِنْسَانِ إِلَّا مَا سَعَىٰ ۙ

41. dhe se përpjekja e tij patjetër do të shikohet;

وَأَنَّ سَعْيَهُ سَوْفَ يُرَىٰ ۙ

42. më pas atij do t'i jepet shpërblimi i plotë;

ثُمَّ يُجْزَاهُ الْجَزَاءَ الْأَوْفَىٰ ۙ

43. dhe se te Zoti yt është fundi;<sup>5</sup>

وَأَنَّ إِلَىٰ رَبِّكَ الْمُنتَهَىٰ ۙ

4. Nga njëra anë, Allahu i Madhërisëm na prezanton Veten me atribute si i Gjithëmëshirshëm, Mëshirëbërës, Bujar, etj., nga ana tjetër sipas këtij ajeti dhe sipas ajetit “ata që përpiqen rreth Nesh, Ne patjetër do t’ua tregojmë rrugët Tona” (29:70), e kushtëzon bekimin e Tij me përpjekjen e njeriut. Mendimi se pa ndonjë përpjekje, vetëm me një të fryrë, do të arrish gjithçka, është tërësisht i gabuar. Pa përpjekjen asgjë nuk arrin dot. Kjo sepse për çdo gjendje që krijohet në zemër, ka nevojë për një shenjë të jashtme. Për shembull, kur zemra të brengoset, të lotojnë sytë. Andaj, Libri i Zotit nuk pranon vetëm një dëshmi, por kërkon edhe dëshminë e dytë, atë të përpjekjes. Vetëm kur njëson dëshirën me përpjekjen, brendinë me të jashtmen, do të arrish diçka. Edhe lutja të hyn në punë kur e shoqëron me përpjekje. Kush mund të jetë më i madh sesa Pejgamberi ynë<sup>savs</sup>?! Ai ishte më i miri i njerëzve, më i larti prej të gjithë Profetëve! Përderisa ai nuk hoqi dorë nga përpjekjet dhe nuk punoi me të fryrë, kush mund të pretendojë të bëjë diçka të tillë?! Profeti<sup>savs</sup> edhe para se të merrte profetërinë, shkante në shpellën Hira duke hequr vështirësi të mëdha. Zoti e di më mirë sesa shumë adhurim dhe përgjërime bënte atje. Kaq shumë përpjekje ai bëri për pastrimin shpirtëror, atëherë Zoti e bekoj atë.

5. Ky ajet thotë se fundi i gjithë zinxhirit të shkaqeve e të pasojave është te Zoti yt. Nëse thellohem pak në këtë argument, mësojmë se të gjitha gjërat janë të lidhura me një zinxhir shkak-pasojë. Për këtë arsye kanë dalë lloj-lloj dijesh në botë, sepse asgjë nuk është jashtë sistemit të krijesave. Disa prej tyre janë trungje dhe disa të tjera janë degë. Dihet që shkak ose lind vetvetiu, ose varet nga një shkak tjetër, dhe ky i fundit nga një tjetër e kështu me radhë. Gjithashtu, nuk mundet që në këtë botë të kufizuar, zinxhiri i shkaqeve dhe i pasojave të mos ketë një fund. Andaj, diku do të përfundojë ky zinxhir. Pikërisht ky fund është Zoti. Lexoni me vëmendje se si ajeti: “Dhe sigurisht, te Zoti yt është fundi.”, me shumë pak fjalë ju parashtron këtë argument.

44. dhe se është Ai që (e) bën të qeshë e të qajë; وَأَنَّهُ هُوَ أَضْحَكَ وَأَبْكَى ۝٤٤
45. dhe se është Ai që jep vdekje dhe jetë; وَأَنَّهُ هُوَ أَمَاتَ وَأَحْيَا ۝٤٥
46. dhe se është Ai që krijoi çiftin, mashkullin e femrën; وَأَنَّهُ خَلَقَ الرُّوحَيْنِ الذَّكَرَ وَالْأُنثَىٰ ۝٤٦
47. prej sperme, kur ajo hidhet; مِنْ نُطْفَةٍ إِذَا تُمْنَىٰ ۝٤٧
48. dhe se pikërisht Ai ka marrë përsipër (edhe) ngritjen tjetër; وَأَنَّ عَلَيْهِ النَّشَأَ الْأُخْرَىٰ ۝٤٨
49. dhe se është Ai që pasuron dhe kënaq; وَأَنَّهُ هُوَ أَعْنَىٰ وَأَقْنَىٰ ۝٤٩
50. dhe se është Ai, Zoti i Siriusit; وَأَنَّهُ هُوَ رَبُّ الشَّعْرَىٰ ۝٥٠
51. dhe se është Ai që shkatërroi adët e parë; وَأَنَّهُ أَهْلَكَ عَادًا الْأُولَىٰ ۝٥١
52. edhe themudët, sa nuk la asgjë (të tyre); وَثَمُودًا فَمَا أَبْقَىٰ ۝٥٢
53. edhe popullin e Nuhut më parë; ata ishin keqbërësit dhe rebelët më të mëdhenj; وَقَوْمَ نُوحٍ مِّنْ قَبْلُ إِنَّهُمْ كَانُوا هُمًّا أَظْلَمَ وَأَطْغَىٰ ۝٥٣
54. edhe qytetet e përmbysura i dërrmoi; وَالْمُوتَفِكَةَ أَهْوَىٰ ۝٥٤
55. atëherë i mbuloi ajo që mbulon. فَعَشَّهَا مَا غَشَّىٰ ۝٥٥
56. E cilën prej mirësive të Zotit tënd do të dyshosh?! فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكَ تَتَمَارَىٰ ۝٥٦
57. Ky është një alarm, i ngjashëm me alarmimet e para. هَذَا نَذِيرٌ مِّنَ النَّذِرِ الْأُولَىٰ ۝٥٧

58. Është afruar e afërta.

أَزْفَتِ الْأَزْفَةُ ۝

59. Kush që e largon nuk ka, përveç Allahut.

لَيْسَ لَهَا مِنْ دُونِ اللَّهِ كَاشِفَةٌ ۝

60. A po çuditeni nga ky ligjërim?!

أَفَمِنْ هَذَا الْحَدِيثِ تَعْجَبُونَ ۝

61. Po qeshni dhe nuk po qani?!

وَتَضْحَكُونَ وَلَا تَبْكُونَ ۝

62. Dhe jeni të shkujdesur?!

وَأَنْتُمْ سَمِدُونَ ۝

63. Bëjini sexhde Allahut dhe adhuroni!

Sexhdeja XIII

فَاعْبُدُوا اللَّهَ وَاعْبُدُوا<sup>الْحَيَّة</sup> ۝

## Surja 54 – El-Kamer

Surja El-Kamer është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka pesëdhjetë e gjashtë ajete.

Në suren paraardhëse u përmend ylli Sirius, të cilin idhujtarët mekas e adhuronin, dhe u tha që zoti i tyre i rremë do të bjerë. Kjo ishte një profeci që parashikonte se idhujtaria e tyre do të shkatërrohej.

Kurse kjo sure që në ajetet e para bën edhe një profeci tjetër dhe thotë – Erdhi ai çast, dhe për këtë dha dëshmi hëna duke u ndarë më dysh. Hëna simbolizon mbretin arab, komentim i cili vjen nga vetë Profeti Muhammed<sup>savs</sup>. Andaj, profecia thoshte – tani e tutje mbretëria idhujtare arabe do të marrë fund, dhe se ka ardhur çasti i revolucionit të madh, që ishte i destinuar të vinte bashkë me Profetin Muhammed<sup>savs</sup>.

Më pas vjen një ajet, i cili tregon qartazi që idhujtarët mekas të asaj kohe e kishin parë me sy për disa çaste që hëna ishte ndarë. Komentuesit kanë bërë komentime të ndryshme, të sakta e të pasakta, por ajo që nuk mund të mohohet është fakti që idhujtarët, po të mos e kishin parë një pamje ku hëna t'u ishte dukur e ndarë në dy pjesë, menjëherë do ta hidhnin poshtë një pretendim të tillë. Po kështu, edhe besimtarët do ta linin besimin e tyre, pasi e gjithë baza e besimit të tyre ishte pikërisht në vërtetësinë e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>. Mirëpo ajeti vijues citon idhujtarët të cilët, pasi e panë ngjarjen, pohuan: “*magji e përsëritur*”, pra, ngjarja ndodhi, por që, sipas tyre, ‘ishte Muhammedi ai që ua bëri magjinë siç u bën gjithmonë’.

Pas kësaj edhe një herë përmenden disa popuj të mëparshëm idhujtarë. Secili prej tyre e quajti të çmendur Profetin e vet, por këta popuj, njëri pas tjetrit, u shkatërruan për shkak të mohimit dhe të shkeljeve të tyre.

Një ajet që përsëritet shpesh në këtë sure thotë: “Ne e bëmë të lehtë Kuranin për mësim”. Nëse u hidhni një sy të vëmendshëm popujve të mëparshëm, do të kuptoni lehtësisht që idhujtaria ose të barazuarit të diçkaje me Zotin është ajo që shkaktoi shkatërrimin më të madh në botë, “por a ka ndonjë që merr mësim?” Fatkeqësisht, nuk e pranuan këshillën shumica as nga të parët, dhe as nga të mëvonshmit.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. U afrua Ora dhe u ça hëna.<sup>1</sup>

اقْتَرَبَتِ السَّاعَةُ وَانْشَقَّ الْقَمَرُ ②

3. E kur shohin ndonjë shenjë, ata shmangen dhe thonë: “Magji e përsëritur!”.

وَإِنْ يَرَوْا آيَةً يُعْرِضُوا وَيَقُولُوا سِحْرٌ مُّسْتَمِرٌّ ③

4. Mohuan, ndoqën dëshirat vetjake (dhe u nxituan); por çdo çështje ka radhën (e vet).

وَكَذَّبُوا وَاتَّبَعُوا أَهْوَاءَهُمْ وَكُلُّ أَمْرٍ مُّسْتَقَرٌّ ④

5. Atyre u kishin ardhur disa lajme që kishin qortim,

وَلَقَدْ جَاءَهُمْ مِنَ الْأَنْبَاءِ مَا فِيهِ مُزْدَجَرٌ ⑤

6. (dhe) urtësi të përsosur, prapëseprapë alarmimet nuk sollën dobi.

حِكْمَةً بَالِغَةً فَمَا تَغْنِ التُّذْرُ ⑥

7. Andaj, shmangu nga ata. (Ata do të shohin) ditën kur thirrësi do t'i thërrasë për një gjë tepër të padëshirueshme.

فَتَوَلَّ عَنْهُمْ يَوْمَ يَدْعُ الدَّاعِ إِلَىٰ شَيْءٍ تُكْرَهُ ⑦

8. Sytë e tyre do të jenë të përlur nga turpi; ata do të dalin nga varret, sikur të jenë karkaleca të shpërndarë.

حُشَعًا أَبْصَارُهُمْ يَخْرُجُونَ مِنَ الْأَجْدَاثِ كَأَنَّهُمْ جَرَادٌ مُّنتَشِرٌ ⑧

9. Do të vrapojnë drejt thirrësit. Mohuesit do të thonë: “Kjo ditë qenka shumë e vështirë!”

مُهْطِعِينَ إِلَى الدَّاعِ يَقُولُ الْكٰفِرُونَ هٰذَا يَوْمٌ عَسِرٌ ⑨

1. Ajeti “u afrua Ora” ose “Kiameti” dhe ajete të tjera të ngjashme (p. sh. 16:78) tregojnë edhe domethënie se çfarë do të thotë *afirim i Kiametit*. Të njëjtin kuptim kanë edhe shenjat e Kiametit që janë përmendur në lidhje me ardhjen e Imam Mehdiut. Edhe ato shenja janë shfaqur tashmë. Për më shumë, lexoni suren 81.

10. Para tyre mohoi edhe populli i Nuhut. Ata e quajtën gënjeshtar robin Tonë dhe thanë: “I çmendur dhe i padëshiruar!”.

كَذَّبَتْ قَبْلَهُمْ قَوْمُ نُوحٍ فَكَذَّبُوا عَبْدَنَا  
وَقَالُوا مَجْنُونٌ وَازْدَجَرَ ۝

11. Ai iu lut Zotit të tij: “Unë vërtet jam i pushtuar, më ndihmo!”

فَدَعَا رَبَّهُ أَنِّي مَغْلُوبٌ فَانْتَصِرْ ۝

12. Atëherë Ne çelëm portat e qiellit që lëshonin ujë pandërprerë.

فَفَتَحْنَا أَبْوَابَ السَّمَاءِ بِمَاءٍ مُنْهَمِرٍ ۝

13. Hapëm edhe tokën me burime, dhe uji arriti deri në një pikë që ishte e paracaktuar.

وَ فَجَّرْنَا الْأَرْضَ عُيُونًا فَالْتَقَى الْمَاءُ  
عَلَى أَمْرٍ قَدْ قُدِرَ ۝

14. (Nuhun) e mbartëm në një (anije) prej dërrasash e gozhdësh.

وَحَمَلْنَاهُ عَلَى ذَاتِ أَلْوَاحٍ وَدُسُرٍ ۝

15. Ajo lundronte para Syve Tanë, si shpërblim i asaj që u mohua (nga mohuesit).

تَجَرَّى بِأَعْيُنِنَا جَزَاءً لِّمَن كَانَ كُفِرَ ۝

16. Ne e lamë (anijen) si një shenjë, andaj, a ka ndonjë që merr mësim?<sup>2</sup>

وَلَقَدْ تَرَكْنَاهَا آيَةً فَهَلْ مِنْ مُدَكِّرٍ ۝

17. Atëherë si ishte ndëshkimi dhe alarmimi Im?!

فَكَيْفَ كَانَ عَذَابِي وَنُذْرٍ ۝

18. Dhe, sigurisht, Ne e bëmë të lehtë Kuranin për mësim, andaj, a ka ndonjë që merr mësim?

وَلَقَدْ يَسَّرْنَا الْقُرْآنَ لِلذِّكْرِ فَهَلْ مِنْ  
مُدَكِّرٍ ۝

2. Ajetet 13 – 16 flasin rreth anijes së Hazret Nuhut<sup>as</sup>, e cila ishte ndërtuar prej dërrasash e gozhdësh, gjë që tregon se deri atëherë qytetërimi ishte zhvilluar deri në masën që njerëzit kishin mësuar të përdornin mirë hekurin. Madje, mund të kenë sajuar edhe ndonjë sharrë për të prerë dërrasa. Rreth kësaj anije, kjo sure thotë – është një shenjë, e tillë që mund t’u shtojë besimin atyre që marrin mësim. Këto fjalë tregojnë se Arka e Nuhut mund të jetë e ruajtur si shenjë për brezat e ardhshëm. Të krishterët, pavarësisht se nuk e dinë këtë deklaratë të Kuranit të Shenjtë, besojnë se Arka e Noes<sup>as</sup> është ruajtur diku dhe kërkojnë kudo për ta zbuluar atë.

19. Mohoi edhe (populli) ad. Atëherë si ishte ndëshkimi dhe alarmimi Im?!

كَذَّبَتْ عَادٌ فَكَيْفَ كَانَ عَدَابُيَّ وَنُذْرِي ۝

20. Njëmend, Ne dërguam kundër tyre një erë të fuqishme në një ditë të kobshme të pafund.

إِنَّا أَرْسَلْنَا عَلَيْهِمْ رِيحًا صَرْصَرًا فِي يَوْمِ نَحْسٍ مُّسْتَمِرٍّ ۝

21. Ajo po i rrëmbente njerëzit, sikur të ishin trungje të shkultura hurmash.

تَنْزِعُ النَّاسَ لَأَكَّاهُمْ أَعْجَارًا مَّخْلُوعَةً ۝

22. Atëherë si ishte ndëshkimi dhe alarmimi Im?!

فَكَيْفَ كَانَ عَدَابُيَّ وَنُذْرِي ۝

23. Dhe, sigurisht, Ne e bëmë të lehtë Kuranin për mësim, andaj, a ka ndonjë që merr mësim?

وَلَقَدْ يَسَّرْنَا الْقُرْآنَ لِلذِّكْرِ فَهَلْ مِنْ مُّذَكِّرٍ ۝

24. (Edhe) themudët i quajtën gënjeshtarë alarmuesit.<sup>3</sup>

كَذَّبَتْ ثَمُودُ بِالنُّذْرِ ۝

25. Thanë: “A të ndjekim një njeri prej nesh?! Atëherë do të jemi në devijim e marrëzi!

فَقَالُوا أَوْ بَشَرَ مِنَّا وَاحِدًا تَتَّبِعُهُ لَإِنَّا إِذَا لَفِئَتُ ضَلَالٍ وَسُعْرِ ۝

26. Mes nesh vetëm atij i paska zbritur mësimi?! Por ai është gënjeshtar i madh (dhe) mburracak.”

ءَأَنْتَی الذِّكْرَ عَلَيْهِ مِنْ بَيْنِنَا بَلْ هُوَ كَذَّابٌ أَشِرٌّ ۝

27. “Nesër do ta mësojnë ata se kush është gënjeshtar i madh (dhe) mburracak!

سَيَعْلَمُونَ عَدَابُيَّ مِنَ الْكَذَّابِ الْأَشِرِّ ۝

3. Të gjithë Profetët janë dërguar nga Zoti dhe një Burim kanë edhe shpalljet e tyre, prandaj, të gjithë Profetët vijnë me të vërteta themelore dhe absolute. Për këtë arsye, ai që refuzon një Profet, pra Profetin e kohës së tij, është sikur të ketë refuzuar të gjithë Profetët. Kjo është arsyeja që në këtë ajet dhe në ajetin 34, “alarmuesit”, pra Profetët, janë përmendur në shumës, edhe pse popujt që janë përmendur, Zoti u kishte dërguar nga një Profet. Kjo temë përmendet edhe në suren 26 Esh-Shu’ara. Shikoni 26:106, 124, 142, 161 dhe 177.



28. Ne do t'u dërgojmë devenë si sprovë, andaj, (o Salih), vëzhgoji dhe duro!

إِنَّا مُرْسَلُوا النَّاقَةَ فِتْنَةً لَهُمْ فَارْتَقِبْهُمْ  
وَاصْطَبِرْ ﴿٢٨﴾

29. Dhe njoftoji që uji është ndarë (sipas orarit) mes tyre. Të jetë i pranishëm për të pirë vetëm ai që ka radhën.”

وَنَبِّئْهُمْ أَنَّ الْمَاءَ قِسْمَةٌ بَيْنَهُمْ كُلُّ  
شِرْبٍ مُحْتَضَرٌ ﴿٢٩﴾

30. Atëherë ata e thirrën shokun e tyre, e kapën (devenë) ia prenë këmbët (dhe e therën).

فَادَاؤُوا صَاحِبَهُمْ فَتَعَاطَى فَعَقَرَ ﴿٣٠﴾

31. Atëherë si ishte ndëshkimi dhe alarmimi Im?!

كَيْفَ كَانَ عَذَابِي وَنُذْرِي ﴿٣١﴾

32. Njëmend, Ne dërguam mbi ta vetëm një krismë, dhe ata u bënë si byk sane.<sup>4</sup>

إِنَّا أَرْسَلْنَا عَلَيْهِمْ صَيْحَةً وَاحِدَةً فَكَانُوا  
كَهَشِيمِ الْمُحْتَظِرِ ﴿٣٢﴾

33. Dhe, sigurisht, Ne e bëmë të lehtë Kuranin për mësim, andaj, a ka ndonjë që merr mësim?

وَلَقَدْ يَسَّرْنَا الْقُرْآنَ لِلذِّكْرِ فَهَلْ مِنْ  
مُّدَكِّرٍ ﴿٣٣﴾

34. (Edhe) populli i Lutit i quajtën gënjeshtarë alarmuesit.

كَذَّبَتْ قَوْمُ لُوطٍ بِالنُّذْرِ ﴿٣٤﴾

35. Njëmend, Ne dërguam mbi ta shi gurësh, por jo (mbi) familjen e Lutit; ata i shpëtuam që në agim;

إِنَّا أَرْسَلْنَا عَلَيْهِمْ حَاصِبًا إِلَّا آلَ لُوطٍ  
نَجَّيْنَاهُمْ بِسَحَرٍ ﴿٣٥﴾

36. si bekim prej Nesh. Ne kështu e shpërblejmë atë që falënderon.

نِعْمَةً مِّنْ عِنْدِنَا ۖ كَذَلِكَ نَجْزِي مَنْ  
شَكَرَ ﴿٣٦﴾

4. Fjalët “*keheshimil-muhtedhir*” tregojnë se mohuesit u dërrmuan dhe u shkatërruan plotësisht, ose ishin bërë aq të pavlefshëm në sytë e Zotit, sa mund të jetë sana e shkelur nga bagëtitë për ndërtuesin ose për ruajtësin e stallës.

37. Edhe ai i kishte alarmuar nga kapja Jonë, prapëseprapë ata mbetën në mëdyshje<sup>5</sup> rreth alarmimeve.

وَلَقَدْ أَنْذَرَهُمْ بَطْشَتَنَا فَتَمَارَوْا  
بِالَّذُرِّ ۝٢٣

38. Tentuan ta ngatërronin atë në lidhje me mysafirët e tij, atëherë Ne ua morëm dritën e syve. “Shijoni ndëshkimin Tim dhe alarmimet e Mia!”

وَلَقَدْ رَاوَدُوهُ عَنْ صَيْفِهِ فَطَمَسْنَا  
أَعْيُنَهُمْ فَذُوقُوا عَذَابِي وَنُذِرِ ۝٢٤

39. Që herët në mëngjes, i zuri një ndëshkim që nuk mbaronte.

وَلَقَدْ صَبَّحَهُمْ بُكْرَةً عَذَابٌ مُسْتَقِرٌّ ۝٢٥

40. Atëherë shijoni ndëshkimin Tim dhe alarmimet e Mia!

فَذُوقُوا عَذَابِي وَنُذِرِ ۝٢٦

41. Dhe, sigurisht, Ne e bëmë të lehtë Kuranin për mësim, andaj, a ka ndonjë që merr mësim?

وَلَقَدْ يَسَّرْنَا الْقُرْآنَ لِلذِّكْرِ فَهَلْ مِنْ  
مُدَّكِرٍ ۝٢٧

42. Edhe familjes së Faraonit i erdhën alarmuesit.

وَلَقَدْ جَاءَ آلَ فِرْعَوْنَ النَّذِرُ ۝٢٨

43. Ata i quajtën gënjeshtër shenjat Tona që të gjitha. Atëherë Ne i kapëm siç kap një Mbizotërues, i Plotfuqishëm.

كَذَّبُوا بِآيَاتِنَا كُلِّهَا فَأَخَذْنَاهُمْ أَخْذَ عَزِيزٍ  
مُقْتَدِرٍ ۝٢٩

44. Po mohuesit tuaj, a janë më të mirë se këta, apo keni ndonjë garanci në Skripte?!

أَكْفَارُكُمْ خَيْرٌ مِنْ أَوْلَادِكُمْ أَمْ لَكُمْ  
بِرَاءَةٌ فِي الزُّبُرِ ۝٣٠

45. A thonë: “Jemi një grup i bashkuar që hakmerret”?!

أَمْ يَقُولُونَ نَحْنُ جَمِيعٌ مُنْتَصِرُونَ ۝٣١

46. Sigurisht, shumica do të shpartalohet dhe do të arratiset!<sup>6</sup>

سَيَهْرَمُ الْجَمْعُ وَيُوَلُّونَ الدُّبُرَ ۝٣٢

5. Për të parë këtë kuptim të foljes *temareu*, shikoni fjalorin “Lisanul-‘Arab”.

6. Ajetet 45 – 46 që janë zbritur në kohën e hershme të Profetit<sup>saws</sup> në Mekë, parashikuan

47. Madje, atyre u është premtuar Ora (e ndryshimit), dhe Ora do të jetë shumë e rëndë dhe shumë e hidhur.

بَلِ السَّاعَةِ مَوْعِدُهُمْ وَالسَّاعَةِ أَذْهَى  
وَأَمْرٌ ۝٤٧

48. Pa dyshim, fajtorët do të jenë në devijim e marrëzi.

إِنَّ الْمُجْرِمِينَ فِي ضَلَالٍ وَ سُعْرٍ ۝٤٨

49. Ditën kur ata do të zvarriten për fytyrash në zjarr. “Shijoni përjetimin e xhehenemit!”

يَوْمَ يُسْحَبُونَ فِي النَّارِ عَلَى وُجُوهِهِمْ  
ذُوقُوا مَسَّ سَقَرَ ۝٤٩

50. Sigurisht, Ne kemi krijuar çdo gjë me masë.

إِنَّا كُلَّ شَيْءٍ خَلَقْنَاهُ بِقَدَرٍ ۝٥٠

51. Dhe urdhri Ynë (vjen) përnjëherë, sa çel e mbyll sytë.

وَمَا أَمْرُنَا إِلَّا وَاحِدَةٌ كَلَمْحٍ بِالْبَصَرِ ۝٥١

52. Dhe, sigurisht, Ne i shkatërrojmë të ngjashmit tuaj (edhe më parë), pra, a ka ndonjë që merr mësim?

وَلَقَدْ أَهْلَكْنَا أَشْيَاعَكُمْ فَهَلْ مِنْ  
مُّدَكِّرٍ ۝٥٢

53. Dhe çdo gjë që bëjnë ata, është përmendur në Skripte.

وَكُلُّ شَيْءٍ فَعَلُوهُ فِي الزُّبُرِ ۝٥٣

54. Dhe çdo gjë e vogël dhe e madhe, është e shënuar.

وَكُلُّ صَغِيرٍ وَ كَبِيرٍ مُّسْتَطَرٌّ ۝٥٤

55. Të druajturit (ndaj Zotit), pa dyshim, do të jenë në kopshte e begati.

إِنَّ الْمُتَّقِينَ فِي جَنَّاتٍ وَنَهْرٍ ۝٥٥

56. Në ulësen e vërtetësisë, pranë Mbretit të Plotfuqishëm.

فِي مَقْعَدِ صِدْقٍ عِنْدَ مَلِكٍ مُّقْتَدِرٍ ۝٥٦

Betejën e Hendekut, në të cilën një ushtri e madhe dhe e bashkuar e mohuesve, e rreshtuar kundër muslimanëve, u detyrua të ikte duke e kthyer shpinën.

## Surja 55 – Err-Rrahman

Surja Err-Rrahman u zbrit në periudhën e hershme mekase. Bashkë me *bismil-lahin*, ajo ka shtatëdhjetë e nëntë ajete.

Për Kuranin e Shenjtë dhe për njeriun, kjo sure përmend dy terma të ndryshëm. Në asnjë ajet nuk është përmendur termi “krijesë” për Kuranin, kurse për njeriun po. Disa grupe muslimane gjatë Mesjetës, po të ishin thelluar në këtë sure, nuk do të luftonin me njëri-tjetrin për temën nëse Kurani është krijesë apo nuk është krijesë, luftë e cila shkaktoi gjakderdhje të mëdha në mesin e muslimanëve.

Kjo sure përmend një peshore (*mizan*) dhe thotë se në tërë qiejt dhe tokën do të shikoni një baraspeshim të përsosur dhe se pikërisht ky baraspeshim është domosdoshmëri për çdo lartësi shpirtërore. Kështu që, edhe robërit besimtarë të Allahut të Madhërishëm, nëse e ruajnë gjithmonë këtë baraspeshim dhe nëse nuk bëjnë asnjë veprim kundër drejtësisë, Allahu i Madhërishëm edhe atyre do t’u dhurojë lartësi të mëdha.

Duke iu drejtuar xhindëve dhe njerëzve, kjo sure në mënyrë të përsëritur i pyet: “Cilën prej mirësive të Zotit tuaj do të mohoni?!” Në këtë kontekst, kjo sure tregon edhe dallimin mes krijimit të xhindëve dhe mes krijimit të njerëzve, duke thënë se xhindët i krijoi prej flakëve të zjarrit. Nisur nga kuptimi i temës së fjalës *xhin* në arabisht, që është *e fshehtë*, *e padukshme*, komentuesit në këtë kohë, e komentojnë emërtimin “*xhin*” me kuptime të ndryshme. Sidoqoftë, njëri prej kuptimeve që aplikohet këtu është se *xhin* nënkupton edhe virusin e bakterin, të cilat u krijuan në etapën e parë të krijimit përmes rrezeve radioaktive që binin prej qiellit në planetin e Tokës. Të gjithë shkencëtarët e kohës sonë janë të mendimit që viruset dhe bakteret e para u fuqizuan prej zjarrit në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Më pas, lidhur me njeriun, vjen një profeci madhështore dhe që zbulon urtësi të shumta dhe sekrete të mëdha në lidhje me krijimin e tij. Krijimi i njeriut përmes baltës është një koncept që e paraqesin thujtë të gjithë Librat e Shenjtë të mëparshëm, por krijimi i tij përmes baltës së thatë kumbuese, është një koncept që gjendet në mënyrë ekskluzive vetëm në Kuranin e Shenjtë. Këtu nuk mund të hyjmë në detaje, por shkencëtarët e dinë shumë mirë që gjatë etapave të krijimit në Tokë, ka ardhur një periudhë kur materia krijuese që po gatitej, duhej të ishte tharë duke u shndërruar pikërisht në formën e një balte të thatë kumbuese. Më pas, deti do ta merrte sërish këtë material të thatë në valët e tij, ku, në udhëtimin e krijimit të njeriut, do të fillonte një zhvillim i tillë kimik, i cili do ta bënte të mundur që kjo materie atëherë e pazëvendësueshme, të mos kthehej më në formën e parë.

Ajeti në fjalë është edhe profeci, pasi kjo si një fakt shkencor do të zbulohet pas shumë shekujsh.

Më pas, vjen një profeci tjetër që parashikon se Allahu i Madhërishëm do të largonte

pengesën midis dy deteve dhe do t'i bashkonte ato.

Pastaj, ka edhe një ajet tjetër, i cili pohon diçka që në kohën kur shpallej Kurani i Shenjtë, asnjë njeri nuk mund ta imagjinonte dot. Në atë kohë, njeriu nuk mund të hidhej në ajër as dy metra lartësi. Kush mund të imagjinonte dot, vallë, që edhe *të fortit*, edhe *të dobëtit*, do të tentonin të fluturonin deri në skajet e qiejve e të tokës?! Por kjo përpjekje e njeriut tanimë ka filluar me vajtjen e tij në Hënë, kurse përpjekjet për të prekur trupat e tjerë më të largët qiellorë, po vijnë. Por, Kurani i Shenjtë parashikoi që njeriu mund t'i prekë skajet e universit, vetëm me anë të argumentit të fortë, dhe jo në ndonjë mënyrë tjetër, dhe se kurdoherë ai të tentojë të fluturojë fizikisht, do të sulmohet nga zjarri dhe bakri i shkrirë. Pa dyshim, shkencëtarët, derisa nuk marrin të gjitha masat për ta shpëtuar anijen kozmike nga gurëzimi që u bëhet nga forcat e trupave qiellorë, nuk mund të udhëtojnë dot në hapësirë.

Pas përmendjes së xhehenemit në një gjuhë konotative, në të njëjtën gjuhë, kjo sure e përmend edhe xhenetin. Lexuesit duhet të dinë që përshkrimi Kuranor nuk ka kuptime fizike, por është i mbushur me gjuhë të figurshme, në të cilën, nëse thellohemi, do të zbulojmë perla nga më të rejtat të spiritualitetit dhe të njohjes së Zotit. Përndryshe, mendja e lexuesit do të endet pa fre në imagjinatat tokësore, duke i sjellë përpara një xhenet krejt fizik, dhe duke e privuar ta gjejë zgjidhjen e shumë pikëpyetjeve.

Shkurt, Allahu i Madhërishëm zotëron bekime të pakufishme, të cilat me të vërtetë nuk mund të llogariten, dhe Ai është Zotëruesi i Madhështisë dhe i Nderit.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit. بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①
2. I Gjithëmëshirshmi الرَّحْمَنِ ①
3. (i) mësoi Kuranin; عَلَّمَ الْقُرْآنَ ①
4. Krijoi njeriun; خَلَقَ الْإِنْسَانَ ①
5. Ia mësoi të shprehurit. عَلَّمَهُ الْبَيَانَ ①
6. Dielli e Hëna (u vunë në shërbim) sipas një llogaritjeje.<sup>1</sup> الشَّمْسُ وَالْقَمَرُ بِحُسْبَانٍ ①
7. Edhe yjet,<sup>2</sup> edhe pemët po bëjnë sexhde. وَالنَّجْمُ وَالشَّجَرُ يَسْجُدَانِ ①
8. Edhe qiellin Ai e ngriti, dhe vendosi peshoren.<sup>3</sup> وَالسَّمَاءَ رَفَعَهَا وَوَضَعَ الْمِيزَانَ ①
9. Që ju të mos e tejkaloni peshoren; أَلَّا تَطْغَوْا فِي الْمِيزَانِ ①
10. të vendosni balancën me drejtësi, dhe të mos pakësoni në peshore. وَأَقِيمُوا الْوَزْنَ بِالْقِسْطِ وَلَا تُخْسِرُوا الْمِيزَانَ ①

1. Fjalët “*bi husban*” në këtë ajet gjithashtu nënkuptojnë se dielli e hëna janë mjete për llogaritje. I gjithë zhvillimi në botë është arritur për shkak të llogaritjes, dhe llogaritjen shkencëtarët e mësuuan në mënyrë të mirëfilltë duke studiuar lëvizjen e diellit dhe të hënës.

2. Fjala “*nexhm*” do të thotë yje, kuptim i cili qëndron dhe vjen në vazhdim të temës së llogaritjes nga ajeti i mëparshëm. Mirëpo kjo fjalë ka edhe kuptimin “bimësi e ulët” dhe, edhe ky kuptim nuk mund të përjashtohet, pasi pas saj përmenden “pemët”. Kjo është shprehësia e lartë e Kuranit të Shenjtë që çdo fjalë dhe çdo ajet është i ndërlidhur me ajetin ose fjalën vijuese.

3. Këtu përmenden lartësitë qiellore, gjë që, në fakt, është esenca e asaj që u tha në ajetet më sipër, pasi pikërisht nëpërmjet llogaritjes, vendoset peshorja, dhe gjithashtu, lartësitë qiellore janë të llogaritura në mënyrë kaq perfekte, që robërit e Zotit mund të mësojnë drejtësinë me anë të tyre.

11. Edhe tokën Ai e rregulloi për krijesat.

وَالْأَرْضَ وَصَعَهَا لِلْأَنَامِ ۝

12. Në të ka fruta, si dhe hurma të mbështjella;

فِيهَا فَاكِهَةٌ وَالنَّخْلُ ذَاتُ الْأَكْمَامِ ۝

13. drithëra me hime, dhe bimë me aromë.

وَالْحَبُّ ذُو الْعَصْفِ وَالرَّيْحَانُ ۝

14. Pra, ju të dy, (o xhindë dhe njerëz), cilën prej mirësive të Zotit tuaj do të mohoni?!<sup>4</sup>

فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبِينَ ۝

15. Ai krijoi njeriun prej një balte të thatë kumbuese porsì poçe.

خَلَقَ الْإِنْسَانَ مِنْ صَلْصَالٍ كَالْفَخَّارِ ۝

16. Dhe xhindin e krijoi prej flake zjarri.

وَخَلَقَ الْجَانَّ مِنْ مَّارِجٍ مِنْ نَّارٍ ۝

17. E cilën prej mirësive të Zotit tuaj do të mohoni?!<sup>5</sup>

فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبِينَ ۝

4. Numri dyjës në foljen “*tukedh-dhiban*” (ju të dy mohoni) mund të jetë përdorur për dy grupet, xhindët dhe njerëzit, të përmendura në ajetin nr. 34, ose mund të nënkuptojë dy shtresa të njerëzve: besimtarët dhe jobesimtarët, udhëheqësit dhe pasuesit e tyre, të pasurit dhe të varfrit, të fortët dhe të dobët, etj.. Në hadith përmendet që Profeti Muhammed<sup>sav</sup>s porositi që kur recitohet ky ajet, besimtarët t’i përgjigjen duke thënë – Nuk mohojmë asnjë nga mirësitë e Tua, o Zoti ynë, dhe e gjithë lavdia është Jotja! (Tefsir Ibn Kethir)

5. Ky ajet përsëritet shpesh në këtë sure. Në fjalën e Zotit dhe në ligjërimet e Profetëve, përsëritja e temave është një veti dalluese, për të treguar një temë të caktuar në mënyra të ndryshme. Qëllimi i përsëritjeve të tilla është që njerëzit në masë të përfitojnë sa më shumë prej tyre. Është në natyrën e njeriut që nëse nuk i thuhet një porosi në mënyrë të përsëritur, shpesh ai nuk e bën. Kjo është njëra prej arsyeve pse jemi urdhëruar të përsërisim disa herë “*Subhane rabbijel-ala*” në namaz. Zoti thotë në Kuran “përkujtoni shumë Allahun që të keni sukses” (62:11). Pra, me përsëritjen njeriu krijon një lidhje me temën dhe arrin ta ngulisë atë në kokë. Atëherë ai krijon një lidhje shpirtërore me të. Ky është qëllimi i përsëritjeve të disa temave në Kuran. Një kritik i thatë mund të quajë përsëritjen si mungesë elokuese, kurse Kuran i Shenjtë nuk e ndjek kritikën e thatë, por synon të shërojë të sëmurin shpirtëror. Kuran vazhdimisht i jep ilaç të sëmurit për t’ia siguruar shërimin e plotë.

18. Zoti i dy Lindjeve dhe Zoti i dy Perëndimeve.<sup>6</sup>

رَبُّ الْمَشْرِقَيْنِ وَرَبُّ الْمَغْرِبَيْنِ ﴿١٨﴾

19. E cilën prej mirësive të Zotit tuaj do të mohoni?!

فَبِأَيِّ آيَةٍ رَّبِّكُمْ تَكْذِبُونَ ﴿١٩﴾

20. Ai lëshoi dy dete të takohen.

مَرَجَ الْبَحْرَيْنِ يَلْتَقِيَانِ ﴿٢٠﴾

21. Mes tyre ka një pengesë, të cilën ato nuk e kapërcejnë dot (përkohësisht).

بَيْنَهُمَا بَرْزَخٌ لَا يَبْغِيَانِ ﴿٢١﴾

22. E cilën prej mirësive të Zotit tuaj do të mohoni?!

فَبِأَيِّ آيَةٍ رَّبِّكُمْ تَكْذِبُونَ ﴿٢٢﴾

23. Prej të dyjave dalin perla e korale.<sup>7</sup>

يَخْرُجُ مِنْهُمَا اللُّؤْلُؤُ وَالْمَرْجَانُ ﴿٢٣﴾

24. E cilën prej mirësive të Zotit tuaj do të mohoni?!

فَبِأَيِّ آيَةٍ رَّبِّكُمْ تَكْذِبُونَ ﴿٢٤﴾

25. (Prej krijimit) të Atij janë edhe anijet, porsì male, të ngritura në det.

وَلَهُ الْجَوَارِ الْمُنشَآتُ فِي الْبَحْرِ كَالْأَعْلَامِ ﴿٢٥﴾

26. E cilën prej mirësive të Zotit tuaj do të mohoni?!

فَبِأَيِّ آيَةٍ رَّبِّكُمْ تَكْذِبُونَ ﴿٢٦﴾

27. Çdo gjë që është mbi të, është e vdekshme,

كُلُّ مَنْ عَلَيْهَا فَانٍ ﴿٢٧﴾

6. Ajeti përmend dy Lindje e dy Perëndime, ndërkohë në kohën e Profetit Muhammed<sup>savs</sup> njerëzit kishin dijeni për vetëm një Lindje dhe një Perëndim. Pra, edhe ky ajet i vogël, përbën një profeci të madhe të zbulimeve të shumta që do të bëheshin në të ardhmen.

7. Ajetet 20 – 23 përmendin dy dete të tilla që kanë perla e korale, dhe që në të ardhmen do të bashkoheshin. Fjalët “do të takohen” përbëjnë një profeci që do të përmbushej në të ardhmen. Ndërkohë, në kohën e Profetit Muhammed<sup>savs</sup> njerëzit nuk dinin për dete të tilla, që të mund të bëhej një profeci e tillë. Deti i Kuq dhe Deti Mesdhe janë ato që nënkuptohen në këto ajete, të cilat i bashkoi Kanali i Suezit.



28. dhe do të mbetet vetëm Fytyra e Zotit tënd, (që është) Zotëruesi i Madhështisë dhe i Nderit.<sup>8</sup>

وَيَبْقَى وَجْهَ رَبِّكَ ذُو الْجَلَالِ وَالْإِكْرَامِ ﴿٢٨﴾

29. E cilën prej mirësive të Zotit tuaj do të mohoni?!

فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبِينَ ﴿٢٩﴾

30. Atij i kërkon çdokush që është në qiej e tokë. Në çdo kohë Ai (manifestohet) në gjendje të re.<sup>9</sup>

يَسْأَلُهُ مَنْ فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ كُلَّ يَوْمٍ هُوَ فِي شَأْنٍ ﴿٣٠﴾

31. E cilën prej mirësive të Zotit tuaj do të mohoni?!

فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبِينَ ﴿٣١﴾

32. Ne së shpejti do të merremi me ju, o ju dy (fuqi) peshërënda!<sup>10</sup>

سَنَفْرَعُ لَكُمْ أَيَّهَ الثَّقَلَيْنِ ﴿٣٢﴾

33. E cilën prej mirësive të Zotit tuaj do të mohoni?!

فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبِينَ ﴿٣٣﴾

34. O grupi i xhindëve dhe i njerëzve! Nëse keni fuqi të dilni nga kufijtë e qiejve e të tokës, atëherë dilni! Nuk do të dilni dot, përveçse me anë të argumentit mbizotërues.<sup>11</sup>

يَمْعَشَرِ الْجِنَّ وَالْإِنْسِ إِنْ اسْتَطَعْتُمْ أَنْ تَنْفُذُوا مِنْ أَقْطَارِ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ فَانْفُذُوا ۗ لَا تَنْفُذُونَ إِلَّا بِسُلْطَانٍ ﴿٣٤﴾

8. Ajetet 27 – 28: Le të përfytyrojmë Tokën të thërrmohet dhe edhe trupat e tjerë qiellorë të copëtohen dhe të fryjë një erë e tillë, që të zhdukë çdo shenjë të tyre. Prapëseprapë, logjika pranon, madje ndërgjegjja e pastër e konsideron të domosdoshme, që pas gjithë këtij asgjësimi, diçka duhet të mbetet si e pavdekshme dhe e patjetërsueshme, e njëjtë me gjendjen e saj të mëparshme. Ky pikërisht është Zoti, që solli në dritë çdo gjë të vdekshme, kurse Vetë është i paprekshëm nga vdekja. Zoti e krijoi njeriun, me qëllim që Ai të njihet përmes fuqisë së Tij krijuese; do t'i shkatërrojë të gjithë, që të njihet përmes fuqisë së Tij shkatërruese, dhe do t'i ringjallë të gjithë një ditë, duke iu dhënë jetë të përsosur dhe duke i tubuar të gjithë në një fushë, që të njihet përmes plotfuqisë së Tij.

9. Kjo do të thotë se atributet e Zotit janë të pakufishme, dhe nuk janë si atributet e njeriut, që janë të kufizuara, andaj, në çdo çast Zoti ka një manifestim të ri.

10. Emri në numrin dyjës “eth-thekalan” që do të thotë *dy gjëra me peshë*, mund të nënkuptojë njerëzit dhe xhindët siç tregon konteksti, ose arabët dhe joarabët ose në gjuhën e sotme politike dy superfuqitë ose dy blloqet kryesore, ose kapitalistët e komunistët, etj..

11. Ajeti thotë: “o grupi i xhindëve dhe i njerëzve”. Zakonisht me xhind njerëzit nënkuptojnë

35. E cilën prej mirësive të Zotit tuaj do të mohoni?!

فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبِينَ ﴿٣٥﴾

36. Do të hidhen mbi ju flaka zjarri dhe një tym, kurse ju nuk do të hakmerreni dot.<sup>12</sup>

يُرْسَلُ عَلَيْكُمَا شُوَاظٌ مِّنْ نَّارٍ وَدُحَاسٌ فَلَا تَنْتَصِرْنَ ﴿٣٦﴾

37. E cilën prej mirësive të Zotit tuaj do të mohoni?!

فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبِينَ ﴿٣٧﴾

38. Pra, kur të çahet qielli, ai do të skuqet porsì lëkurë e kuqe.<sup>13</sup>

فَإِذَا انشَقَّتِ السَّمَاءُ فَكَانَتْ وَرْدَةً كَالدِّهَانِ ﴿٣٨﴾

39. E cilën prej mirësive të Zotit tuaj do të mohoni?!

فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبِينَ ﴿٣٩﴾

40. Atë ditë nuk do të pyetet për mëkatën e tij as njeriu e as xhindi.<sup>14</sup>

فَيَوْمَئِذٍ لَا يُسْأَلُ عَنْ ذَنْبِهِ إِنْسٌ وَلَا جَانٌّ ﴿٤٠﴾

41. E cilën prej mirësive të Zotit tuaj do të mohoni?!

فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبِينَ ﴿٤١﴾

një krijesë të çuditshme, për të cilën ndoshta edhe mund të thuhet se ajo ka mundësi të dalë nga “skajet e qiejve e të tokës”, por për “ins”, pra për njerëzit, në kohën e Profetit Muhammed<sup>savs</sup> askush nuk mund të imagjinonte dot se ata do të përpiqen të fluturojnë drejt skajeve të qiejve e të Tokës. Ajo që është me rëndësi të theksojmë në këtë ajet është që nuk thuhet vetëm “kufijtë e tokës”, por “kufijtë e qiejve e të tokës”, pra, do të tentojnë ta kapërcejnë gjithë universin me një hedhje të vetme. Fjalët “*përveçse me anë të argumentit mbizotërues*” (arab. *il-la bisultan*) tregojnë që përpjekjet e njerëzve në këtë drejtim do të kenë sukses vetëm nëpërmjet logjikës dhe arsyes. Është pikërisht kjo që shohim sot. Shkencëtarët arrijnë të zbulojnë lajmet e një largësie prej njëzet miliardë vitesh drite nëpërmjet logjikës dhe llogaritjeve të tyre, kurse fizikisht kjo është e pamundur për ta.

12. Anijet kozmike kur tentojnë të kapërcejnë lartësi të ndryshme në hapësirë, ato sulmohen pikërisht prej një lloj zjarri e tymi që përmendet në këtë ajet.

13. Kjo duket se është një metaforë dhe që flet për zhvillimin e jashtëzakonshëm në fushën e kozmologjisë. Mund të nënkuptojë edhe luftëra të tmerrshme ajrore.

14. Ky ajet thotë se atë ditë njerëzit dhe xhindët nuk do të pyeten për mëkatet e tyre. Ditën e Gjykimit fajtori do të dallohet me shenjat e tij dhe nuk do të lindë nevoja fare për pyetjet. Edhe në luftërat botërore as vendet e fuqishme nuk pyesin vendet e vogla, e as shtetet e vogla komuniste nuk pyesin shtetet e mëdha kapitaliste. Megjithatë, duket se kjo pjesë e profecisë, me kalimin e kohës, ka nevojë të zbardhet më shumë.

42. Fajtorët do të njihen me shenjat e tyre, dhe do të kapen për ballukesh dhe për këmbësh.

يَعْرِفُ الْمَجْرُمُونَ بِسِيمَاهُمْ فَيُؤْخَذُ  
بِالنَّوَاصِي وَالْأَقْدَامِ ﴿٤٢﴾

43. E cilën prej mirësive të Zotit tuaj do të mohoni?!

فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبِينَ ﴿٤٣﴾

44. Ky është xhehenemi që fajtorët e quanin gënjeshtër.

هَذِهِ جَهَنَّمُ الَّتِي يُكَذِّبُ بِهَا الْمَجْرُمُونَ ﴿٤٤﴾

45. Ata do të sillen mes tij dhe mes një uji tepër të valuar.

يُطَوَّفُونَ بَيْنَهَا وَبَيْنَ حَمِيمٍ إِنِ ﴿٤٥﴾

46. E cilën prej mirësive të Zotit tuaj do të mohoni?!

فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبِينَ ﴿٤٦﴾

47. Dhe për atë që frikësohet nga pozita e Zotit të tij, do të ketë dy xhenete.<sup>15</sup>

وَلِمَنْ خَافَ مَقَامَ رَبِّهِ جَنَّاتٍ ﴿٤٧﴾

48. E cilën prej mirësive të Zotit tuaj do të mohoni?!

فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبِينَ ﴿٤٨﴾

49. Që të dyja me degë të shumta.

ذَوَاتَا أَفْئَانٍ ﴿٤٩﴾

50. E cilën prej mirësive të Zotit tuaj do të mohoni?!

فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبِينَ ﴿٥٠﴾

51. Në të dyja, rrjedhin dy burime.

فِيهِمَا عَيْنَانِ تَجْرِيانِ ﴿٥١﴾

52. E cilën prej mirësive të Zotit tuaj do të mohoni?!

فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبِينَ ﴿٥٢﴾

15. Ai që heq dorë nga mëkatet, duke pasur druajtje ndaj Pozitës dhe Nderit të Zotit të Madhërishtëm dhe duke pasur frikë se një ditë do të japë llogari përpara Tij, do të ketë dy xhenete. 1) Që në këtë botë, atij do t'i jepet një jetë prej xheneti, pra, ai do të fitojë ndryshim të pastër shpirtëror, dhe Vetë Zoti do të bëhet Mik dhe Kujdestar i tij. 2) Pas vdekjes së tij, atij do t'i dhurohet xheneti i përjetshëm, sepse ai pati frikë ndaj Zotit dhe Atij i dha përparësi mbi dynjanë dhe mbi dëshirat vetjake dhe tokësore.

53. Në to ka çdolloj frute në çifte.

فِيهِمَا مِنْ كُلِّ فَاكِهَةٍ زَوْجَيْنِ ﴿٥٣﴾

54. E cilën prej mirësive të Zotit tuaj do të mohoni?!

فَبِأَيِّ آيَاتِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبِينَ ﴿٥٤﴾

55. (Banorët e xhenetit) do të jenë të mbështetur në shtrojë, mbulesa e të cilave do të jetë prej mëndafshi të trashë. Frutat e pjekura të të dyja xheneteve do të varen deri poshtë nga pesha.

مُتَّكِنِينَ عَلَى فُرُشٍ بَطَّائِنُهَا مِنْ إِسْتَبْرَقٍ ۗ  
وَجَا الْجَنَّتَيْنِ دَانٍ ﴿٥٥﴾

56. E cilën prej mirësive të Zotit tuaj do të mohoni?!

فَبِأَيِّ آيَاتِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبِينَ ﴿٥٦﴾

57. Në to do të ketë virgjëresha me sy të përlurur; nuk do t'i ketë prekur përpara tyre as ndonjë njeri, e as xhind.

فِيهِنَّ قُصِرَتِ الظُّرُفُ ۗ لَمْ يَطْمِئِنَّ  
النُّسُ قَبْلَهُمْ وَلَا جَانٌّ ﴿٥٧﴾

58. E cilën prej mirësive të Zotit tuaj do të mohoni?!

فَبِأَيِّ آيَاتِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبِينَ ﴿٥٨﴾

59. Ato do të jenë porsu rubinë dhe korale.

كَانَّهُنَّ الْيَاقُوتُ وَالْمَرْجَانُ ﴿٥٩﴾

60. E cilën prej mirësive të Zotit tuaj do të mohoni?!

فَبِأَيِّ آيَاتِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبِينَ ﴿٦٠﴾

61. Shpërblimi i mirësisë a mund të jetë gjë tjetër përveç mirësisë?!

هَلْ جَزَاءُ الْإِحْسَانِ إِلَّا الْإِحْسَانُ ﴿٦١﴾

62. E cilën prej mirësive të Zotit tuaj do të mohoni?!

فَبِأَيِّ آيَاتِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبِينَ ﴿٦٢﴾

63. Përveç këtyre të dyjave, ka edhe dy xhenete të tjera.

وَمِنْ دُونِهَا جَنَّاتٍ ﴿٦٣﴾

64. E cilën prej mirësive të Zotit tuaj do të mohoni?!

فَبِأَيِّ آيَاتِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبِينَ ﴿٦٤﴾

65. Që të dyja me gjelbërim të thellë.

مُدَّهَا مُتْنًا ۝

66. E cilën prej mirësive të Zotit tuaj do të mohoni?!

فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبِينَ ۝

67. Në to ka dy burime që gurgullojnë.

فِيهِمَا عَيْنَانِ نَضَّاخَتَيْنِ ۝

68. E cilën prej mirësive të Zotit tuaj do të mohoni?!

فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبِينَ ۝

69. Në to ka fruta, hurma e shegë.

فِيهِمَا فَاكِهَةٌ وَرَجُلٌ وَرَمَانٌ ۝

70. E cilën prej mirësive të Zotit tuaj do të mohoni?!

فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبِينَ ۝

71. Në to ka virgjëresha të bukura shumë të virtytshme.

فِيهِنَّ خَيْرَاتٌ حِسَانٌ ۝

72. E cilën prej mirësive të Zotit tuaj do të mohoni?!

فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبِينَ ۝

73. Hyri symëdha që qëndrojnë nëpër çadra.

حُورٌ مَّقْصُورَاتٌ فِي الْبِحَامِ ۝

74. E cilën prej mirësive të Zotit tuaj do të mohoni?!

فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبِينَ ۝

75. Nuk do t'i ketë prekur përpara tyre (pra, përpara banorëve të xhenetit) as ndonjë njeri, e as xhind.

لَمْ يَطْمِئِنَّهُنَّ أَنْسَ قَبْلَهُمْ وَلَا جَانٌّ ۝

76. E cilën prej mirësive të Zotit tuaj do të mohoni?!

فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبِينَ ۝

77. Do të jenë në mbështetëse të gjelbra dhe qilima të bukur.

مُتَّكِنِينَ عَلَى رَفْرَفٍ خُضْرٍ وَوَعَبَقَرِيِّ

حِسَانٌ ۝

78. E cilën prej mirësive të Zotit tuaj do të mohoni?!

فَبِأَيِّ آيَاتِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبْنَ ﴿٧٨﴾

79. Zotëruesi i bekimeve është emri i Zotit tënd, Zotëruesi i Madhështisë dhe i Nderit.

بِذِكْرِ اسْمِ رَبِّكَ ذِي الْجَلَالِ وَالْإِكْرَامِ ﴿٧٩﴾

## Surja 56 – El-Vakia

Surja El-Vakia është zbritur në vitet e para të periudhës mekase. Bashkë me *bismillahin*, ajo ka nëntëdhjetë e shtatë ajete.

Në fillim të kësaj sureje është përmendur se profecitë madhështore që bëri surja paraardhëse, do të realizohen patjetër, sidomos ato që kanë lidhje me ringjalljen pas vdekjes.

Pas kësaj, përmendet një krahasim midis sakrificëbërësve të periudhës së parë të Islamit dhe atyre që i përkasin periudhës së fundit të tij. Krahasimi tregon që të dyja grupet e sakrificëbërësve do të kenë ngjashmëri të shumta me njëri-tjetrin, për sa i përket llojit të sakrificave të tyre, dhe po kështu, për sa u përket edhe shpërblimeve të punëve të tyre. Por, për nga numri dhe niveli, të parët do të kenë epërsi mbi të mëvonshmit. Megjithatë, edhe nga grupi i fundit, do të jenë disa të tillë që do të gëzojnë nivelet dhe bekimet, që u janë dhënë të parëve.

Gjithashtu, përmenden edhe të ligjtë e të dyja kohërave, të cilët janë quajtur *të majtë*. Janë përmendur edhe vetitë e tyre që i çojnë deri në xhehenem.

Surja Vakia përshkruan gjendjen e banorëve të xhehenemit dhe të xhenetit me një gjuhë konotative. Në këtë kontekst, e thekson: mos mendoni se do të ringjallenit me të njëjtin trup që keni pasur në jetën tokësore, por do të ringjallenit si një krijim kaq i avancuar, të cilin nuk mund ta perceptoni dot.

Ajetet 61 e 62 u thonë njerëzve: Ju nuk keni asnjë njohuri se në çfarë gjendjeje do t'ju ringjallë Zoti. Nëse mendojmë pak, kjo në vetvete është një informacion për atë gjendje. Në të vërtetë, Kurani na tërheq vëmendjen që nuk duhet t'i marrim këto ajete me kuptimin e tyre të drejtpërdrejtë, pasi ato janë figura, realen e të cilave nuk e dimë ende.

Pastaj janë përmendur katër gjëra që janë aq thelbësore saqë nëse dikush i mendon duke qenë i paanshëm, do të pohojë patjetër se përveç Zotit askush nuk ka mundësi t'i krijojë ato:

(1) Është ajo materie që shkakton lindjen e njeriut, në të cilën janë përmbledhur attribute të panumërta, të cilat pas lindjes, shfaqen përmes organeve të tij, si syri, veshi, hunda, gjuha, fyti, aparati i të folurit, etj.. Të gjitha këtyre organeve u janë dhënë udhëzime kaq të përpikta, saqë ato dinë shumë mirë se deri ku duhet të zhvillohen dhe kur duhet të ndalen së zhvilluari. Marrim shembullin e dhëmbëve. Dhëmbët e qumështit dalin në një periudhë të caktuar dhe bien pas një kohe të caktuar gjatë fëmijërisë. Kështu, fëmijët që nuk kanë mundësi të kujdesen për shëndetin e dhëmbëve, shpëtojnë nga dëmet e tyre. Pastaj, për dhëmbët e pjekurisë njeriu vetë është përgjegjës që të kujdeset. Edhe ata, pse nuk rriten pas një zhvillimi të caktuar?! Çfarë është ajo që i ndalon të rriten më shumë? Sepse kështu është programuar në ADN-në e njeriut, dhe sipas këtij caktimi prej Zotit, ata veprojnë

në këtë mënyrë. Shkencëtarët thonë se dhëmbët rriten me një shpejtësi që është afërsisht e njëjtë me shpejtësinë e konsumimit të tyre. Nëse ata nuk do ta kishin sistemin e ndalimit të zhvillimit, dhe të rriteshin pa ndalim, dhëmbët e poshtëm mund të përshkonin trurin e njeriut, ndërsa ata të sipërmit do t'i çajnë nofullat e do t'i preknin gjoksin. Pra, Kurani e pyet njeriun: Vetë e ke bërë këtë sistem gjenetik në trupin tënd? Sigurisht që jo.

(2) Në të njëjtën mënyrë, njeriu hedh farën në tokë, por nuk e kujton faktin se sa i ndërlikuar është sistemi, përmes të cilit nga ato fara dalin pemë, perime, fruta dhe gjëra të tjera, të gjitha këto që nuk mund të lindnin vetvetiu.

(3) Po ashtu, njeriu nuk sundon as shiun që zbret nga qielli e që i jep mbështetje jetës në këtë tokë.

(4) Sërish, edhe zjarri vepron sipas urdhrit të Zotit, dhe njeriu duke e përdorur atë, dëshiron të ngjitet në qiell. Ai zjarr në vend që ta çojë njeriun lart, mund edhe ta djegë atë. Lidhur me këtë, ju kujtojmë profecinë e Hazret Profetit Muhammed<sup>savs</sup> në të cilën ai parashikon *gomarin e Dexhallit*, pra, fluturime dhe anije kozmike, të cilat do të lëviznin me zjarr, por udhëtarët që do të uleshin në to, nuk do të digjeshin nga ai.

Pastaj përmendet dëshmia e grumbujve të yjeve. Njeriu i kohës kur ishte zbritur Kurani, mendonte se yjet janë si perla të vogla ose gurë që xixëllojnë. Por Zoti thotë: Nëse do të merrni vesh se çfarë janë ato me të vërtetë, do të befasoheni. Sot ne e dimë që ato janë aq të mëdha saqë dielli, hëna, toka dhe të gjithë planetët e tjerë mund të vijnë në një cep të vogël të një grumbulli yjesh. Ndaj, kjo sure thotë – *Dëshmia e yjeve që po japim Ne, është një dëshmi shumë e madhe*.

Pas këtyre dëshmimeve thotë se edhe Kurani i Shenjtë është një Libër “i fshehtë”. Ashtu siç yjet që ju duken të vogla, madje edhe të padukshme për shkak të largësisë së tyre, në të njëjtën mënyrë nuk mund të arrini lehtë lartësitë e Kuranit, pavarësisht se atë e shihni si një Libër të vogël. Pastaj thotë se në dukje ju edhe mund ta prekni Kurantin me dorë, pra fizikisht gjendeni kaq afër atij, por në temat e tij mund të thellohet vetëm ai, të cilit Zoti Vetë ia pastron shpirtin.





1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit. بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①
2. Kur do të ndodhë Ngjarja! إِذَا وَقَعَتِ الْوَاقِعَةُ ①
3. Asnjë (shpirt) nuk mund ta përgënjeshtrojë atë. لَيْسَ يُوَفِّعَتَهَا كَاذِبَةٌ ①
4. (Disa) do t'i ulë, (disa) do t'i lartësojë. خَافِضَةٌ رَّافِعَةٌ ①
5. Kur toka do të tronditet fort. إِذَا رُجَّتِ الْأَرْضُ رَجًا ①
6. Dhe malet do të thërrmohen tërësisht. وَبَسَّتِ الْجِبَالُ بَسًّا ①
7. Dhe ato do të bëhen si grimca të shpërndara. فَكَانَتْ هَبَاءً مُتَّبَثًا ①
8. Ndërkohë, ju do të jeni në tri grupe. وَكُنْتُمْ أَزْوَاجًا ثَلَاثَةً ①
9. Njerëzit e së djathtës; ç'janë ata të së djathtës?! فَأَصْحَابُ الْمَيْمَنَةِ ① مَا أَصْحَابُ الْمَيْمَنَةِ ①
10. Njerëzit e së majtës; ç'janë ata të së majtës?! وَأَصْحَابُ الْمَشْأَمَةِ ① مَا أَصْحَابُ الْمَشْأَمَةِ ①
11. Dhe parakaluesit do t'i parakalojnë (të gjithë). وَالسَّيْفُونَ السَّيْفُونَ ①
12. Këta do të jenë të afruarit. أُولَئِكَ الْمُقَرَّبُونَ ①
13. Në xhenete plot bekime. فِي جَنَّاتٍ النَّعِيمِ ①

14. Do të jenë me shumicë në të parët.

ثُلَّةٌ مِنَ الْأَوَّلِينَ ۝١٤

15. Dhe pakicë në të mëvonshmit.

وَقَلِيلٌ مِنَ الْآخِرِينَ ۝١٥

16. Do të jenë nëpër frone të stolisura.

عَلَى سُرُرٍ مَّوْضُونَةٍ ۝١٦

17. Të mbështetur mbi to, përballë njëri-tjetrit.

مُتَّكِنِينَ عَلَيْهَا مُتَقَابِلِينَ ۝١٧

18. Djem<sup>1</sup> të përjetshëm do të sillen rreth tyre (për t'iu shërbyer).

يُطَوَّفُ عَلَيْهِمْ وَإِلْدَانٌ مُّحَلَّدُونَ ۝١٨

19. Me tase, shtamba e gota të mbushura me pije të kulluar.

بِأَكْوَابٍ وَأَبَارِيقٍ وَكَأْسٍ مِّن مَّعِينٍ ۝١٩

20. Prej të cilës, ata as nuk do të kenë marramendje, e as nuk do të flasin përçart.<sup>2</sup>

لَّا يَصَدَّعُونَ عَنْهَا وَلَا يُنَزِفُونَ ۝٢٠

21. (Djemtë në shërbim të tyre) me fruta, nga ato që ata dëshirojnë.

وَفَاكِهَةٍ مِّمَّا يَتَخَيَّرُونَ ۝٢١

22. Dhe me mish zogjsh, që ata pëlqejnë.

وَلَحْمِ طَيْرٍ مِّمَّا يَشْتَهُونَ ۝٢٢

23. Dhe hyri symëdha.

وَحُورٍ عِينٍ ۝٢٣

1. Fjala arabe “*vildan*” që është në këtë ajet, mund të përkthehet edhe “bij”, pra “bij të përjetshëm”, sepse është shumësi e emrit “*veled*” ose “*vulejd*”, që do të thotë bir, djalë.

2. Ajetet 19 – 20 tregojnë qartazi për një pije që është krejtësisht e pastër nga ndikimet që kanë pijet alkoolike. Pra, pija e xhenetit as nuk do t'i dehë xhenetlinjtë, as nuk do t'u japë dhimbje koke dhe as nuk do t'i bëjë ta humbin kontrollin. Andaj, “vera” e xhenetit nuk ka asnjë lidhje me verën e kësaj bote, madje ajo ka efekt të kundërt. Përveç kësaj, në asnjë ajet të Kuranit nuk është thënë se “vera” e xhenetit do të jetë, për shembull, prej rrushit, thane etj., sepse ajo realisht nuk ka asnjë përbërje të gjërave tokësore. Përkundrazi, sipas Kuranit të Shenjtë rezultojnë që përbërësit e saj janë dashuria dhe njohja e Zotit, të cilat robi i merr me vete që nga kjo botë. Nëse shtrohet pyetja: si mundet që një ndjesi shpirtërore do të kthehet në pije në botën tjetër?, përgjigjja është se kjo është një prej fshehtësive të botës tjetër që Zoti do ta zbulojë atje, por njohësit e Zotit përmes *keshfeve* (vizioneve) e kuptojnë deri diku këtë sekret që në këtë botë, dhe po kështu, edhe të mençurit e kuptojnë thelbin duke parë shenjat e tij.

24. Porsi perla të mbuluara. كَأَمْثَالِ اللُّؤْلُؤِ الْمَكْنُونِ ﴿٢٤﴾
25. Si shpërblim i asaj që ata bënin. جَزَاءً بِمَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿٢٥﴾
26. Nuk do të dëgjojnë atje as kotësi e as mëkat. لَا يَسْمَعُونَ فِيهَا لُعَاوًا وَلَا نَفِيًا ﴿٢٦﴾
27. Por vetëm thënie: “Paqe!”  
“Paqe!”<sup>3</sup> إِلَّا قِيلًا سَلَامًا سَلَامًا ﴿٢٧﴾
28. Dhe njerëzit e së djathtës; ç’janë ata të së djathtës? وَاصْحَابُ الْيَمِينِ ﴿٢٨﴾ مَا أَصْحَابُ الْيَمِينِ ﴿٢٨﴾
29. Mes hidesh pa gjemba فِي سِدْرٍ مَّخْضُودٍ ﴿٢٩﴾
30. dhe bananesh palë-palë. وَوَطْحٍ مُنْضُودٍ ﴿٣٠﴾
31. Dhe (mes) hijesh të zgjatura. وَوَظِلٍّ مَّمْدُودٍ ﴿٣١﴾
32. Dhe (mes) ujëvarash وَمَاءٍ مَّسْكُوبٍ ﴿٣٢﴾
33. dhe frutash me bollëk. وَفَاكِهَةٍ كَثِيرَةٍ ﴿٣٣﴾
34. Që as nuk do të sosen, dhe as nuk do të jenë të ndaluara. لَا مَقْطُوعَةٍ وَلَا مَمْنُوعَةٍ ﴿٣٤﴾
35. Dhe (mes) fronesh të ngritura. وَقُرُوشٍ مَّرْفُوعَةٍ ﴿٣٥﴾
36. Pa dyshim, bashkëshortet e tyre, Ne i kemi krijuar bukur. إِنَّا أَنْشَأْنَهُنَّ إِنشَاءً ﴿٣٦﴾
37. I krijuam virgjëresha. فَجَعَلْنَهُنَّ أَبْكَارًا ﴿٣٧﴾

3. Ajetet 26 – 27, si shumë ajete të tjera të Kuranit, hedhin poshtë të gjitha idetë për një xhenet a parajsë sensuale, të cilat disa mendjelehtë pretendojnë ta gjejnë në botën tjetër, duke mos kuptuar realitetin e botës së përtejme. Xheneti siç e përshkruan Kurani i Shenjtë është një vend që do të jetë burim i lumturisë, i paqes dhe i pëlqimit të Zotit, ku banorët e tij jo vetëm që nuk bëjnë ndonjë mëkat, madje nuk do të përfshihen as edhe në një kotësi të vetme. Edhe biseda e tyre do të jetë vetëm për paqe shpirtërore (78:36). Xheneti që Zoti ia premtonte besimtarëve në Kuran është shtëpia e paqes (6:128), është lumturia më e madhe që mund të arrijë një shpirt paqedashës dhe është shtëpia pranë Krijuesit të tij (89:28).

38. Magjepsëse e moshatare.

عُرْبًا أَتْرَابًا ۞

39. Për njerëzit e së djathtës.

عَلَىٰ صُحُبِ الْأَيْمَنِ ۞

40. Do të jenë me shumicë nga të parët.

ثُلَّةٌ مِنَ الْأُولَىٰ ۞

41. Me shumicë (edhe) nga të mëvonshmit.<sup>4</sup>

وَأُثَّةٌ مِنَ الْأٰخِرِينَ ۞

42. Dhe njerëzit e së majtës; ç'janë ata të së majtës?

وَأَصْحَابُ الشَّمَالِ ۞

43. Do të jenë në erëra të nxehta dhe ujë të valuar.

فِي سَمُومٍ وَحَمِيمٍ ۞

44. Në hije prej tymi

وَأَظْلٍ مِّنْ يَّحْمُومٍ ۞

45. As të freskët, e as qetësuese.

لَا بَارِدٍ وَلَا كَرِيمٍ ۞

46. Ata deri më parë ishin të kamur.

إِنَّهُمْ كَانُوا قَبْلَ ذَلِكَ مُتْرَفِينَ ۞

47. Dhe insistonin për mëkatet e mëdha.

وَكَانُوا يُصِرُّونَ عَلَى الْحِنثِ الْعَظِيمِ ۞

48. Dhe thoshin: “Kur do të vdesim e do të bëhemi pluhur dhe eshtra, a do të ngrihemi prapë?!”

وَكَانُوا يَقُولُونَ ۞ أَيُّدَا مِنَّا وَكُنَّا تُرَابًا  
وَ عِظَامًا ۞ إِنَّا لَمَبْعُوثُونَ ۞

49. Vallë, edhe etërit tanë të parë?!”

أَوْ آبَاؤُنَا الْأَوَّلُونَ ۞

4. Në ajetet 40 – 41, Allahu i Madhërishëm ka premtuar dy periudha ose dy kohëra të ndihmës dhe të udhëzimit të Tij. Njëra kohë është e Profetit Muhammed<sup>savs</sup> dhe e dyta është e atij Mesihu që do të vinte në *umetin* e Muhammedit. Ngjashëm me këtë, Ai tha: “(Ai e dërgoi atë) edhe te të mëvonshmit prej tyre, të cilët ende nuk u janë bashkuar” (62:4). Në këtë ajet, Allahu i Madhërishëm na dha profecinë për Mesihun e Premtuar dhe për xhematin e tij dhe për ata njerëz që do ta ndiqnin Mesihun e Premtuar. Shkurt, në rrafshin kohor Kurani i ndan muslimanët në dy grupe: të parët dhe të mëvonshmit. Natyrisht, çdo grup e ka një Imam. Imami i të mëvonshmeve është pikërisht Imam Mehdiu dhe Mesihu i Premtuar.

50. Thuaj: “Pa dyshim, edhe të parët, edhe të mëvonshmit,

قُلْ إِنَّ الْأَوَّلِينَ وَالْآخِرِينَ ۝٥٠

51. kanë për t’u mbledhur për një kohë (e) ditë të caktuar.

لَمَجْمُوعُونَ إِلَىٰ مِيقَاتِ يَوْمٍ مَّعْلُومٍ ۝٥١

52. Pastaj, o ju të devijuar mohues!

ثُمَّ إِنَّكُمْ أَيُّهَا الضَّالُّونَ الْمَكِدِّبُونَ ۝٥٢

53. Do të hani prej pemës së zekkumit.<sup>5</sup>

لَا يَكُونُ مِنْ شَجَرٍ مِّنْ زُقُومٍ ۝٥٣

54. Me të do ta mbushni barkun.

فَمَا لِيُونَ مِنْهَا الْبُطُونَ ۝٥٤

55. Pastaj do të pini ujë të valuar.

فَشَرِبُونَ عَلَيْهِ مِنَ الْحَمِيمِ ۝٥٥

56. Dhe do të pini si deve tepër të etshme.”

فَشَرِبُونَ شُرْبَ الْهَيْمِ ۝٥٦

57. Kjo do të jetë “mikpritje” për ta Ditën e Gjykimit.

هَذَا نُزِّلَهُمْ يَوْمَ الدِّينِ ۝٥٧

58. Ne ju kemi krijuar, e pse nuk vërtetoni?

نَحْنُ خَلَقْنَاكُمْ فَكُلُوا لَنُصَدِّقُوا ۝٥٨

59. A keni menduar për spermën që hidhni (në mitër)?

أَفَرَأَيْتُمْ مَا تُمْنُونَ ۝٥٩

60. A jeni ju që e keni krijuar atë, apo jemi Ne Krijuesit?!

ءَ أَنْتُمْ تَخْلُقُونَهَا أَمْ نَحْنُ الْخَالِقُونَ ۝٦٠

61. Ne e caktuam vdekjen mes jush, dhe ju nuk mund të Na mundni dot.

نَحْنُ قَدَرْنَا بَيْنَكُمْ الْمَوْتَ وَمَا نَحْنُ بِمَسْبُوقِينَ ۝٦١

62. Që t’ju ndryshojmë formën dhe t’ju ngremë në atë mënyrë që ju nuk e dini.

عَلَىٰ أَنْ تُبَدِّلَ أَمْثَالَكُمْ وَنُنشِئَكُمْ فِي مَا لَا تَعْلَمُونَ ۝٦٢

5. Lexoni 37:63-66.

63. Ju, sigurisht, e keni ditur krijimin e parë. Atëherë pse nuk merrni mësim?!

وَلَقَدْ عَلِمْتُمُ النَّشْأَةَ الْأُولَىٰ فَلَوْلَا تَذَكَّرُونَ ﴿١٦﴾

64. A keni menduar për atë që mbillni?!

أَفَرَأَيْتُمْ مَا تَحْرثُونَ ﴿١٧﴾

65. A jeni ju që e rrisni, apo jemi Ne Rritësit?!

ءَأَنْتُمْ تَرْعَوْنَہَ أَمْ نَحْنُ الزَّارِعُونَ ﴿١٨﴾

66. Po të donim, do ta kishim bërë pluhur, dhe ju do të mbeteshit duke thënë:

لَوْ نَشَاءُ لَجَعَلْنَاهُ حُطَامًا فَظَلْتُمْ تَفَكَّهُونَ ﴿١٩﴾

67. “Kemi falimentuar!

إِنَّا لَمُعْرِمُونَ ﴿٢٠﴾

68. Madje, kemi ngelur pa gjë fare!”

بَلْ نَحْنُ مَحْرُومُونَ ﴿٢١﴾

69. A keni menduar për ujin që pini?!

أَفَرَأَيْتُمُ الْمَاءَ الَّذِي تَشْرَبُونَ ﴿٢٢﴾

70. A jeni ju që e zbrisni nga retë, apo jemi Ne Zbritësit?!

ءَأَنْتُمْ أَنْزَلْتُمُوهُ مِنَ الْمُزْنِ أَمْ نَحْنُ

الْمُنزِلُونَ ﴿٢٣﴾

71. Po të donim, do ta kishim bërë të njelmët. Pra, pse nuk falënderoni?!

لَوْ نَشَاءُ لَجَعَلْنَاهُ أَسْفَلَ فَلَؤَلَا

تَشْكُرُونَ ﴿٢٤﴾

72. A keni menduar për zjarrin që ndizni?!

أَفَرَأَيْتُمُ النَّارَ الَّتِي تُورُونَ ﴿٢٥﴾

73. A jeni ju që bëni pemën e tij, apo jemi Ne Bërësit?!<sup>6</sup>

ءَأَنْتُمْ أَنْشَأْتُمْ شَجَرَتَهَا أَمْ نَحْنُ

الْمُنشِئُونَ ﴿٢٦﴾

74. Ne e kemi bërë atë për mësim dhe për dobi të udhëtarëve.

نَحْنُ جَعَلْنَاهَا تَذَكُّرًا وَ مَتَاعًا لِلْمُقْوِينَ ﴿٢٧﴾

75. Andaj, përkujto emrin e Zotit tënd të Madhërishëm!

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اسْمِعُوا بَيْنَ يَدَيْهِ عَسَىٰ أَنْ تُحْشَرُوا يَوْمَ الْقِيَامِ ﴿٢٨﴾

6. Fjalët “pema e zjarrit” gjithashtu nënkuptojnë flakën e zjarrit në formë peme. Për këtë kuptim të këtyre fjalëve, shikoni “Et-Tefsir El-Kebir” të ‘Allame Fakhruddin Er-Raziut.

76. Beto hem për vendshfaqjet e yjeve!

فَلَا أَقْسِمُ بِمَوْقِعِ التَّجْوَمِ ۗ

77. Dhe ky është një betim shumë i madh, nëse e dini.

وَإِنَّهُ لَقَسَمٌ لَّو تَعْلَمُونَ عَظِيمٌ ۗ

78. Sigurisht, ky Kuran është i nderuar;

إِنَّهُ لَقُرْآنٌ كَرِيمٌ ۗ

79. (i ruajtur) në një Libër të fshehtë.

فِي كِتَابٍ مَّكْنُونٍ ۗ

80. Asnjë nuk e prek dot, përveç të pastërve.<sup>7</sup>

لَا يَمَسُّهَا إِلَّا الْمُطَهَّرُونَ ۗ

81. Zbritja (e tij) është prej Zotit të botëve.

تَنْزِيلٌ مِّن رَّبِّ الْعَالَمِينَ ۗ

82. A po bëheni hipokritë ndaj këtij ligjërimi?!

أَفِيهِدَا الْحَدِيثِ أَنْتُمْ مُدْهِنُونَ ۗ

83. Dhe po fitoni bukën tuaj sepse po mohoni?!

وَتَجْعَلُونَ رِزْقَكُمْ أَنْكُمْ تُكذِّبُونَ ۗ

84. Por (atij që është afër vdekjes) kur (shpirti) i vjen te fyti për të dalë;

فَلَوْلَا إِذَا بَلَغَتِ الْحُلُقُومَ ۗ

7. Ajetet 76-80: Duke u betuar në vendshfaqjet e yjeve (në ajetin nr. 76), Allahu i Madhërishtëm na tërhoqi vëmendjen që ashtu siç yjet duken si pika të vogla për shkak të largësisë së tyre, por që në të vërtetë janë jo të vogla, por shumë të mëdha, në të njëjtën mënyrë, Kurani i Nderuar, për shkak të lartësive të tij të jashtëzakonshme, është i fshehtë për ata që kanë "shikim" të dobët. Kurse ata të cilëve u pastrohet megjulla shpirtërore, i arrijnë lartësitë e Kuranit. Njëherësh, në këto ajete, Zoti i Madhërishtëm na tërhoqi vëmendjen edhe për sekretet e mëdha të Kuranit të Nderuar, të cilat Ai ua zbulon vetëm njerëzve të zgjedhur, pra atyre, të cilët Ai i pastron Vetë. Njeriu nuk mund ta fitojë dot dijen Hyjnore përmes marifeteve të tij. Për t'i arritur dijet e fesë si dhe njohuritë e pastra shpirtërore, pastrimi shpirtëror dhe largimi nga rrugët e papastra janë domosdoshmëri. Kjo për arsye se *nefsi* i pastër ka një ngjashmëri me Kurantin e Shenjtë dhe për shkak të kësaj ngjashmërie, njohuritë e Kuranit shpalosen në zemrën e tij të pastër dhe ai arrin t'i njohë ato, t'i nuhasë ato, dhe zemra e tij e pohon – ja, kjo është e vërteta. Pra, zemra e robit të pastër bëhet një kriter i përshtatshëm për ta peshuar të vërtetën. E gjithë kjo provon nevojën për një mësues për të kuptuar Kurantin, një mësues të cilin Zoti i Madhërishtëm Vetë t'ia ketë pastruar shpirtin. Po të mos ishte sot nevoja për mësuesin për të kuptuar Kurantin, as në fillim nuk do të kishte nevojë për një mësues (pra, Profetin<sup>savs</sup>) për ta kuptuar atë.

85. dhe ju vetëm e shikoni.

وَأَنْتُمْ حِينِيذٍ تَنْظُرُونَ ﴿٤٥﴾

86. Kurse Ne jemi më afër tij sesa ju, por ju nuk shihni qartë.

وَنَحْنُ أَقْرَبُ إِلَيْهِ مِنْكُمْ وَلَكِنْ لَا تَبْصُرُونَ ﴿٤٦﴾

87. Atëherë nëse ju nuk jeni nga ata që japin llogari,

فَلَوْ لَا إِنْ كُنْتُمْ عَيْرَ مَدِينِينَ ﴿٤٧﴾

88. përse nuk e rikthyet atë (shpirtin e vdekur), nëse jeni të vërtetë?!

تَرْجِعُونَهَا إِنْ كُنْتُمْ صَادِقِينَ ﴿٤٨﴾

89. E tani, nëse (i vdekuri) është nga të afruarit (me Zotin),

فَأَمَّا إِنْ كَانَ مِنَ الْمُقَرَّبِينَ ﴿٤٩﴾

90. ka rehati dhe aromë (për të) dhe xhenet plot bekime.

فَرَوْحٌ وَرَيْحَانٌ وَجَنَّتْ نَعِيمٍ ﴿٥٠﴾

91. E nëse është nga njerëzit e së djathtës,

وَأَمَّا إِنْ كَانَ مِنَ أَصْحَابِ الْيَمِينِ ﴿٥١﴾

92. atëherë (i thuhet): “Paqe për ty, o ti që je nga njerëzit e së djathtës!”

فَسَلِّمْ لَكَ مِنْ أَصْحَابِ الْيَمِينِ ﴿٥٢﴾

93. Dhe nëse është prej mohuesve të devijuar,

وَأَمَّا إِنْ كَانَ مِنَ الْمُكَذِّبِينَ الضَّالِّينَ ﴿٥٣﴾

94. atëherë, zbarkimi (i tij) është në ujë të valuar

فَأَنْزَلْنَا مِنْ حَمِيمٍ ﴿٥٤﴾

95. dhe pjekja në xhehenem.

وَأَصْلِيَّةً جَحِيمٍ ﴿٥٥﴾

96. Kjo pikërisht është e vërteta e sigurt.

إِنَّ هَذَا لَهُوَ حَقُّ الْيَقِينِ ﴿٥٦﴾

97. Andaj, përkujto emrin e Zotit tënd të Madhërisëm!

بِسْمِ رَبِّكَ الْعَظِيمِ ﴿٥٧﴾



## Surja 57 – El-Hadid

Surja El-Hadid është medinase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka tridhjetë ajete.

Në hapje të saj, kjo sure deklaron se qiejt, toka dhe gjithçka që ato kanë e përkujtojnë Allahun, dhe se pikërisht Allahu është i Pari dhe i Fundit, i Dukshmi dhe i Padukshmi. Pra, manifestimet e Tij janë kudo, por për sytë që nuk kanë aftësi ta shohin Atë, Ai mbetet i Padukshëm.

Duke treguar shembullin e jetës tokësore, kjo sure pohon se ajo është thjesht një lojë e argëtim, dhe nuk është diçka e përhershme. Kur njeriu do t'i afrohet vdekjes, atëherë do ta kuptojë se ai ka jetuar vetëm disa ditë.

Po në këtë sure vjen edhe ajeti kuptimplotë, i cili tregon qartazi që Allahu i Madhërishëm i ka treguar Profetit Muhammed<sup>savs</sup> se xheneti e xhehenemi nuk do të jenë në formë tokësore. Konkretisht, në ajetin nr. 22, Allahu i Madhërishëm thotë: *“Garoni për faljen prej Zotit tuaj dhe (për) xhenetin, gjerësia e të cilit është sa gjerësia e qiellit dhe e tokës!”* Kur i Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> e lexoi këtë ajet, sahabët e pyetën: O i Dërguari i Allahut! Nëse xheneti është kaq i gjerë, ku do të jetë xhehenemi?

Edhe ai aty do të jetë – iu përgjigj i Dërguari i Allahut<sup>savs</sup>. (“Musned Ahmed”, Musned el-mekin, nr. i hadithit 15100; “Tefsir Er-razi” kom. 3:133)

Me fjalë të tjera, Profeti<sup>savs</sup> u tha – Edhe xheneti edhe xhehenemi aty janë, por ju nuk e ndieni këtë. Kjo qartazi tregon se Allahu i Madhërishëm i kishte treguar Profetit Muhammed<sup>savs</sup> një koncept të Relativitetit, pra, dy gjëra që mund të jenë në të njëjtin vend, por për shkak të dimensioneve të tyre të ndryshme, ato nuk përzihen me njëra-tjetrën.

Ajeti qendror i kësaj sureje nga vjen edhe emri i sures, është ai në të cilin Allahu i Madhërishëm deklaron: *“Ne kemi zbritur hekurin”*. Me fjalën *“nuzul”* (zbritje) muslimanët në përgjithësi kuptojnë zbritjen fizike, dhe po këtë kuptim përpiqen t’ia veshin *“zbritjes”* së Hazret Isait<sup>as</sup>. Por ne të gjithë e dimë që hekuri nuk zbret ose nuk bie prej qiellit, përkundrazi, ai merret duke gërmuar tokën. Kështu që, ky ajet na jep shpjegimin e *“zbritjes”*, që Kurani i Shenjtë e ka përdorur këtë folje edhe për gjërat që janë tejet të dobishme për njerëzimin. Po me këtë kuptim Kurani i Shenjtë e ka përdorur këtë folje edhe për bagëtitë, për veshjen, dhe mbi të gjitha, për vetë Profetin Muhammed<sup>savs</sup>, siç tha: *“Sigurisht, Allahu ka zbritur për ju këshillë (dhe) një të Dërguar ...”* (65:11-12).

Të gjithë dijetarët muslimanë unanimisht besojnë se Profeti Muhammed<sup>savs</sup> nuk është zbritur fizikisht prej qiellit. Prandaj, edhe atje, zbritja nuk ka tjetër kuptim përpos që pikërisht Profeti Muhammed<sup>savs</sup> do të ishte i Dërguari më dobiprurës për mbarë njerëzimin.

Po në këtë sure, Allahu i Madhërishëm thotë për sahabët<sup>ra</sup>, që drita e tyre vrapon përpara tyre dhe në të djathtën e tyre. Si të thuash, ata shohin rrugën përmes dritës së tyre që u jep Allahu.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Allahun e lartëson<sup>1</sup> gjithçka që është në qiej dhe (në) tokë; dhe Ai është Mbizotëruesi, i Urti.

سَبَّحَ لِلَّهِ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ② وَهُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ③

3. I Atij është sundimi i qiejve dhe i tokës. Ai jep jetë e vdekje; dhe Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë.

لَهُ مُلْكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ④ يُحْيِي وَيُمِيتُ ⑤ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ⑥

4. Ai është i Pari, i Fundit, i Dukshmi dhe i Fshehti; dhe Ai është i Gjithëdijshëm për çdo gjë.

هُوَ الْأَوَّلُ وَالْآخِرُ وَالظَّاهِرُ وَالْبَاطِنُ ⑦ وَهُوَ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ ⑧

5. Është Ai që krijoi qiejt dhe tokën në gjashtë ditë, më pas u vendos në Arsh.<sup>2</sup> Ai di atë që hyn në tokë dhe

هُوَ الَّذِي خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ فِي سِتَّةِ أَيَّامٍ ثُمَّ اسْتَوَىٰ عَلَى الْعَرْشِ ⑨

1. Në Kuran shpesh vjen fjala *seb-beha* ose *juseb-bihu*, që në shqip, e përkthejmë *lartësuj*. Nga kjo vijnë edhe *tesbih*, *subhanAllah*. *Seb-beha* rrjedh nga *sebeha*, e cila ka kuptimet: noton, rrjedh me shpejtësi, pa pengesë e pa ndalesa; kryerja e një pune me shpejtësi pa hasur asnjë vështirësi. Pra, kushti i veprimtës është që ai të jetë i plotë dhe të mos ketë mangësi, të meta, etj.. Në Kuranin e Shenjtë kjo si folje, emër e mbiemër vjen në ajete të ndryshme. Për shembull, thotë *ves-sabihatu sebhan* (ato që notojnë shumë) (79:4); *jesbahun* (secili nga trupat qiellorë po *lundron* në një orbitë) (36:41); për punët e Profetit Muhammed<sup>savs</sup> Zoti e përdori këtë fjalë duke thënë *sebhan tavilen* (gjatë ditës, ti ke *angazhime* të gjata) (73:8); etj.. Pra, e gjithë kjo tregon se fjala *sebeha* shënjon rrjedhën pa ndalesa, shpejtësinë, punën e plotë, etj.. Kjo folje përdoret edhe në mënyrë veprorë, pra, *seb-beha lil-lahi* e *juseb-bihu lil-lahi*, ku vepruesit janë krijesat dhe objekti për të cilin bëhet ose shprehet veprimi, është Krijuesi, dhe kuptimi i saj është që krijesat shprehin se Krijuesi është *i patëmetë*, *i shenjtë*, *i saktë në punët e Tij*, *i pagabueshëm në vendimet e Tij*, etj.. Emri prejfoljor është pikërisht *tesbih*. Kështu që, *tesbih* do të thotë të lartësosh Zotin duke përmendur shenjtërinë e Tij, patëmetësinë e Tij, saktësinë e Tij etj.. Po nga kjo rrjedh shprehja *subhanAllah*, që themi për të treguar se Zoti është *i Shenjtë* dhe *i Patëmetë*. Andaj, kur thuhet se çdo gjë e universit i bën *tesbih* Zotit, do të thotë se çdo gjë në univers kryen me përpikëri të gjitha detyrat që janë përcaktuar për të dhe, duke vepruar në këtë mënyrë, ajo jo vetëm shënjon Krijuesin e vet, por gjithashtu edhe e lartëson Atë dhe dëshmon se Krijuesi i saj është i Pastër nga çdo e metë. Lexoni edhe 64:2.

2. Pasi krijoi gjithë universin dhe krijesat në gjashtë ditë, Zoti u vendos në *Arsh* (Fron). Kjo do

atë që del prej saj; si dhe atë që zbret prej qiellit dhe atë që ngjitet në të.<sup>3</sup> Ai është me ju, kudo që të jeni. Dhe Allahu është Gjithëshikues për atë që bëni.

6. I Atij është sundimi i qiejve dhe i tokës, dhe tek Ai kthehen çështjet.

7. Ai fut natën në ditë dhe fut ditën në natë; dhe Ai është i Gjithëdijshëm për gjithçka që mbajnë kraharorët.

8. Besoni në Allah dhe (në) të Dërguarin e Tij, dhe shpenzoni nga ajo për të cilën Ai ju ka bërë mëkëmbës. Ata që besuan prej jush dhe shpenzuan, do të kenë shpërblim shumë të madh.

9. E çfarë ju ndodhi që nuk besoni në Allah?! Kurse i Dërguari ju thërret që

يَعْلَمُ مَا يَلِجُ فِي الْأَرْضِ وَمَا يَخْرُجُ مِنْهَا وَ مَا يَنْزِلُ مِنَ السَّمَاءِ وَ مَا يَعْرُجُ فِيهَا ۗ وَهُوَ مَعَكُمْ أَيْنَ مَا كُنْتُمْ ۗ وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ بَصِيرٌ ﴿٥﴾

لَهُ مُلْكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ۗ وَ إِلَى اللَّهِ تُرْجَعُ الْأُمُورُ ﴿٦﴾

يُورِثُ الْيَتِيمَ فِي النَّهَارِ وَيُورِثُ النَّهَارَ فِي اللَّيْلِ ۗ وَهُوَ عَلِيمٌ بِذَاتِ الصُّدُورِ ﴿٧﴾

أٰمِنُوٓا بِاللّٰهِ وَرَسُوْلِهِ ۗ وَاَنْفِقُوٓا مِمَّا جَعَلَكُمْ مُسْتَحْلِفِيْنَ فِيْهِ ۗ فَاَلَّذِيْنَ اٰمَنُوٓا مِنْكُمْ وَاَنْفَقُوٓا لَهُمْ اَجْرٌ كَبِيْرٌ ﴿٨﴾

وَمَا لَكُمْ لَا تُؤْمِنُوْنَ بِاللّٰهِ ۚ وَالرَّسُوْلَ يَدْعُوْكُمْ لِتُؤْمِنُوٓا بِرَبِّكُمْ وَقَدْ اٰخَذَ

të thotë se pas krijimit të krijesave, Ai vuri në fuqi atributet e Tij të drejtësisë dhe të mëshirës. Vendosja e Tij në Fronin Hyjnor simbolizon që pas krijimit, Ai nuk u tërhoq nga krijesat, përkundrazi, secilën prej tyre filloi ta drejtojë përmes attributeve të Tij. Një shembull i thjeshtë mund të jetë ai i fronit të një mbreti. Kur mblidhet gjithë paria në oborrin mbretëror dhe përgatiten të gjitha çështjet për të cilat kërkohet vendimi ose gjykimi, atëherë vjen mbreti, hijeshon kuvendin, fillon seancën dhe lëshon dekrete. Bibla e quajti ditën e shtatë si ditë pushimi për Perëndinë (Zanafilla 2:2-3), por ajo është thjesht një metaforë, që tregon se kur një njeri përfundon një punë të madhe, i vjen kohë pushimi. Kurani i Shenjtë e hedh poshtë kuptimin e drejtpërdrejtë të kësaj metafore, duke treguar se ajo nuk ishte ditë pushimi, por ditë sundimi. Lexoni edhe 7:55.

3. Fjalët “Ai di atë që hyn në tokë dhe atë që del prej saj ...” tregojnë që në çdo çast ka gjëra që dalin nga toka për t’u ngjitur në qiell, dhe anasjelltas. Ndër to ka avuj etj., të cilët rikthehen në tokë, por ka edhe rrezatime magnetike apo të gravitetit, që kapërcejnë atmosferën e Tokës. Po kështu, meteorët si dhe rrezet radioaktive vazhdimisht hyjnë në planetin e Tokës. Shkencëtarët pavarësisht se kanë zbuluar shumë gjëra në këtë drejtim, prapëseprapë, ende janë të paditur për shumë rreze që hyjnë në Tokë. Edhe kjo temë ishte tërësisht e pakapshme për njeriun e kohës së Profetit Muhammed<sup>saws</sup>, por që Kurani i Shenjtë e cek në këto ajete.

të besoni në Zotin tuaj, dhe (o bijtë e Ademit), Ai ka marrë besën prej jush; (andaj, do të jetë mirë për ju) nëse bëheni besimtarë.

مِيثَاقَكُمْ إِنْ كُنْتُمْ مُؤْمِنِينَ ⑩

10. Është Ai që zbret mbi robin e Tij ajete të qarta, që t'ju nxjerrë ju nga errësirat drejt dritës. Pa dyshim, Allahu ndaj jush është shumë i Dhembshur, shumë Mëshirëbërës.

هُوَ الَّذِي يُنَزِّلُ عَلَى عَبْدِهِ آيَاتٍ بَيِّنَاتٍ لِيُخْرِجَكُمْ مِنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ ۗ وَإِنَّ اللَّهَ بِكُمْ لَرَءُوفٌ رَحِيمٌ ⑩

11. E çfarë ju ndodhi që nuk shpenzoni në rrugën e Allahut, ndërkohë që e Allahut është trashëgimia e qiejve dhe e tokës?! Mes jush askush nuk mund të jetë i barabartë me atë që shpenzoi përpara fitores dhe luftoi. Këta janë më të lartë në gradë sesa ata që shpenzuan më vonë dhe luftuan. Dhe Allahu secilit i ka premtuar më të mirën. Allahu është i Gjithinformuar për atë që bëni.

وَمَا لَكُمْ أَلَّا تُنْفِقُوا فِي سَبِيلِ اللَّهِ وَلِلَّهِ مِيرَاثُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ۗ لَا يَسْتَوِي مِنْكُمْ مَن أنْفَقَ مِنْ قَبْلِ الفَتْحِ وَقَتْلَ أُولِيكَ أَعْظَمُ دَرَجَةً ۗ مَنِ الَّذِينَ أنْفَقُوا مِنْ بَعْدِ وَقْتِنَا ۗ وَكُلًّا وَعَدَ اللَّهُ الْحَسَنَى ۗ وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرٌ ⑪

12. Kush është që i jep Allahut një hua të mirë, që Ai t'ia shumëfishojë atë? Dhe ai do të ketë edhe shpërblim të nderuar.

مَنْ ذَا الَّذِي يُقْرِضُ اللَّهَ قَرْضًا حَسَنًا فَيُضِعُّهُ لَهُ ۗ وَلَهُ أَجْرٌ كَرِيمٌ ⑪

13. Ditën kur do t'i shohësh besimtarët dhe besimtare, që drita e tyre vrapon përpara tyre dhe në të djathtë e tyre. "Sot i gëzofshi xhenetet, nëpër të cilat rrjedhin lumenj!" Ata në to do të jetojnë përgjithmonë. Ky pikërisht është suksesi madhor.

يَوْمَ تَرَى الْمُؤْمِنِينَ وَالْمُؤْمِنَاتِ يَسْعَى نُورُهُمْ بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَبِأَيْمَانِهِمْ بُشْرَاكُمْ الْيَوْمَ جَاءَتْ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا ۗ ذَلِكَ هُوَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ ⑫

14. Ditën kur hipokritët dhe hipokritet do t'u thonë atyre që

يَوْمَ يَقُولُ الْمُنْفِقُونَ وَالْمُنْفِقَاتُ لِلَّذِينَ

besuan: “Na shikoni, (që) edhe ne të marrim diçka nga drita juaj!” Do t’u thuhet: “Kthehuni mbrapa dhe (atje) kërkoni ndonjë dritë!” Atëherë do të hidhet një mur mes tyre që do të ketë një derë. Brenda tij do të ketë mëshirë, kurse nga jashtë, përpara tij, ndëshkim.

15. Ata do t’i thërrasin me zë të lartë: “A nuk kemi qenë me ju?!” (Besimtarët) do të përgjigjen: Patjetër që po, por ju e vutë veten në sprovë, pritët dhe ratë në dyshime, dhe ju mashtruan “ëndrrat”, derisa erdhi vendimi i Allahut, ndërkohë që djalli ju kishte mashtruar në lidhje me Allahun.

16. Andaj, sot nuk do t’ju pranohet ndonjë shpagim as juve, e as atyre që mohuan. Streha juaj është zjarri; ai është “miku” juaj. Sa destinacion i keq është ai!<sup>4</sup>

17. A nuk ka ardhur koha për ata që besuan, që zemrat t’u përgjërohen me përkujtimin e Allahut dhe me të vërtetën që Ai zbriti, dhe të mos bëhen sikur ata të cilëve u ishte dhënë Libri më parë, dhe të cilëve iu zgjat koha, derisa iu ngurtësuan zemrat?! Dhe shumica prej tyre ishin të pabindur.

أَمْوَا أَنْظَرُونَا نَقْتَبِسُ مِنْ نُورِكُمْ ۗ قِيلَ  
ارْجِعُوا وَرَاءَكُمْ فَأَنْتِمُسُوا نُورًا ۗ  
فَضْرِبَ بَيْنَهُمْ بِسُورٍ لَهُ بَابٌ بَاطِنُهُ  
فِيهِ الرَّحْمَةُ وَظَاهِرُهُ مِنْ قِبَلِهِ  
الْعَذَابُ ۗ

يَا أَيُّدُونَهُمُ الَمْ نَكُنْ مَعَكُمْ ۗ قَالُوا بَلَىٰ  
وَلَكِن كُنتُمْ فِتْنَةٌ أَنْفُسِكُمْ وَ تَرَبَّصْتُمْ  
وَأَرْبَبْتُمْ وَعَرَّيْتُمْ الْأُمَانِيَّ حَتَّىٰ جَاءَ  
أَمْرُ اللَّهِ وَعَرَّيْتُمْ بِاللَّهِ الْعُرُورُ ۗ

فَالْيَوْمَ لَا يُؤَخَذُ مِنْكُمْ فِدْيَةٌ وَلَا مِنَ  
الَّذِينَ كَفَرُوا ۗ مَا أُولَئِكَ التَّارُ ۗ هِيَ  
مَوْلَاكُمْ ۗ وَبِئْسَ الْمَصِيرُ ۗ

الَمْ يَأْنِ لِلَّذِينَ آمَنُوا أَنْ تَخْشَعَ قُلُوبُهُمْ  
لِذِكْرِ اللَّهِ وَمَا نَزَلَ مِنَ الْحَقِّ ۗ وَلَا يَكُونُوا  
كَالَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ مِنْ قَبْلُ فَطَالَ  
عَلَيْهِمُ الْأَمَدُ فَقَسَتْ قُلُوبُهُمْ ۗ وَكَثِيرٌ  
مِّنْهُمْ فَسِقُونَ ۗ

4. Fjalët “ai është miku juaj” duket se janë ironi, sepse mëkatarët në jetën tokësore zjarrin e dëshirave e bëjnë “mik”. Megjithatë, këto fjalë gjithashtu mund të kenë kuptimin se vetëm zjarri i xhehenemit mund t’i pastrojë ata nga papastërtitë dhe sëmundjet me të cilat ata e ngarkuan veten e tyre. Pra, në këtë kuptim, shërimi i tyre do të bëhet nga ky “mik” që është zjarri i xhehenemit. Lexoni edhe 78:24.

18. Dijeni se Allahu ringjall tokën pas vdekjes së saj. Ne ju kemi shpjeguar hollësisht ajetet, që të kuptoni.

19. Për bamirësit dhe bamirëset, dhe për ata që i dhanë hua të mirë Allahut, Ai do ta shumëfishojë atë dhe ata do të kenë shpërblim të nderuar.<sup>5</sup>

20. Ata që besuan në Allah dhe (në) të Dërguarit e Tij, pikërisht këta janë të vërtetët dhe dëshmorët pranë Zotit të tyre. Ata do ta kenë shpërblimin dhe dritën e tyre. Kurse ata që mohuan dhe i quajtën gënjeshtër ajetet Tona, pikërisht këta do të jenë banorë të xhehenemit.

21. Dijeni se jeta e kësaj bote është vetëm lojë, dëfrim, zbukurim, mburrje ndërmjet njëri-tjetrit dhe garë për t'u shtuar në pasuri e (në) pasardhës; ajo është si shiu, gjelbërimi i të cilit i mahnit bujqit, më pas ai thahet dhe ti e sheh të zverdhur, dhe më pas bëhet pluhur. Në ahiret ka edhe ndëshkim të rëndë, edhe falje e pëlqim prej Allahut; kurse jeta e kësaj bote është vetëm një përfitim i përkohshëm (dhe) mashtrues.<sup>6</sup>

إِعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ يَحْيِي الْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا ۗ  
قَدْ بَيَّنَّا لَكُمُ الْآيَاتِ لَعَلَّكُمْ تَعْقِلُونَ ﴿١٨﴾

إِنَّ الْمُصَّدِّقِينَ وَالْمُصَّدِّقَاتِ وَأَقْرَضُوا  
اللَّهَ قَرْضًا حَسَنًا يُضَعَّفَ لَهُمْ وَلَهُمْ  
أَجْرٌ كَرِيمٌ ﴿١٩﴾

وَالَّذِينَ آمَنُوا بِاللَّهِ وَرُسُلِهِ أُولَٰئِكَ هُمُ  
الصَّادِقُونَ ۗ وَالشُّهَدَاءُ عِنْدَ رَبِّهِمْ ۗ لَهُمْ  
أَجْرُهُمْ وَنُورُهُمْ ۗ وَالَّذِينَ كَفَرُوا  
كَذَّبُوا بِآيَاتِنَا أُولَٰئِكَ أَصْحَابُ الْجَحِيمِ ﴿٢٠﴾

إِعْلَمُوا أَنَّمَا الْحَيَاةُ الدُّنْيَا لَعِبٌ ۗ وَهُوَ  
وَزِينَةٌ ۗ وَتَفَاخُرٌ بَيْنَكُمْ وَتَكَاثُرٌ فِي  
الْأَمْوَالِ وَالْأَوْلَادِ ۗ كَمَثَلِ غَيْثٍ  
أَعْجَبَ الْكُفَّارَ نَبَاتُهُ ثُمَّ يَهْمُجُ فَتَرَاهُ  
مُصْفَرًّا ۗ ثُمَّ يَكُونُ حُطَامًا ۗ وَفِي الْآخِرَةِ  
عَذَابٌ شَدِيدٌ ۗ وَمَغْفِرَةٌ مِّنَ اللَّهِ  
وَ رِضْوَانٌ ۗ وَمَا الْحَيَاةُ الدُّنْيَا إِلَّا مَتَاعٌ  
الْغُرُورِ ﴿٢١﴾

5. Është praktikë e Kuranit të Shenjtë që disa herë një fjalë të caktuar e përdor jo në kuptimin e parë, por në kuptimin metaforik të saj, siç është edhe në këtë ajet. Huaja dihet që merret atëherë kur huamarrësi është nevojtar. Pra, kur njeriu nuk ia del dot me mjetet e veta, i kërkon hua tjetrit me zotimin se do ta shlyejë për më vonë. Por Allahu i Madhërishtëm nuk është nevojtar ndaj askujt, madje Ai ia plotëson nevojat çdokujt. Kështu që, fjala hua nuk është përdorur në kuptimin e nevojës, por vetëm në kuptimin e marrjes së parave me premtimin se Ai do t'ia paguajë plotësisht huadhënësit, madje në mënyrë të shumëfishtë.

6. Jeta që njeriu kalon në harresë ndaj Zotit dhe me shpërfillje ndaj vlerave të saj më të larta është si ajo që përshkruhet në këtë ajet, përndryshe jeta e njeriut në tokë ka një mision shumë

22. Garoni për faljen prej Zotit tuaj dhe (për) xhenetin, gjerësia e të cilit është sa gjerësia e qiellit dhe e tokës!<sup>7</sup> Ai është përgatitur për ata që besuan në Allah dhe (në) të Dërguarit e Tij. Ky është bekimi i Allahut, që Ai ia jep kujt të dojë; dhe Allahu ka bekim të madh.

23. Nuk bie ndonjë fatkeqësi në tokë, e as në jetën tuaj, përveçse të jetë e shkruar në një Libër, përpara se Ne ta shfaqim atë. Kjo për Allahun është e lehtë.<sup>8</sup>

24. Që ju të mos brengoseni për atë që ju ka humbur, dhe as të mos mburreni për atë që Ai ju ka dhënë. Allahu nuk do asnjë mendjemadh (dhe) mburravec;

25. (pra,) ata që tregohen koprracë dhe urdhërojnë njerëzit për koprraci. Kushdo që e kthen shpinën, (le ta dijë) se Allahu është i Pavaruri, i Lavdishmi.

26. Sigurisht, Ne dërguam të Dërguarit Tanë me shenjat e qarta dhe bashkë me ta, zbritëm Librin dhe peshoren, që njerëzit të veprojnë me

سَابِقُونَ إِلَىٰ مَعْرَةٍ مِّن رَّبِّكُمْ وَجَنَّةٍ  
عَرْضُهَا كَعَرْضِ السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ ۗ  
أَعَدَّتْ لِلَّذِينَ آمَنُوا بِاللَّهِ وَرُسُلِهِ ۗ ذَلِكَ  
فَضْلُ اللَّهِ يُؤْتِيهِ مَن يَشَاءُ ۗ وَاللَّهُ  
ذُو الْفَضْلِ الْعَظِيمِ ﴿٧﴾

مَا أَصَابَ مَن مَّقْصَبَةٍ فِي الْأَرْضِ وَلَا فِي  
أَنْفُسِكُمْ إِلَّا فِي كِتَابٍ مِّن قَبْلِ أَنْ نَبْرَأَهَا  
إِنَّ ذَلِكَ عَلَى اللَّهِ يَسِيرٌ ﴿٨﴾

لِكَيْلَا تَأْسَوْا عَلَىٰ مَا فَاتَكُمْ وَلَا تَفْرَحُوا  
بِمَا آتَاكُمْ ۗ وَاللَّهُ لَا يُحِبُّ كُلَّ مُخْتَالٍ  
فَخُورٍ ﴿٩﴾

الَّذِينَ يَبْحَلُونَ وَيَأْمُرُونَ النَّاسَ بِالْبَحْلِ ۗ  
وَمَنْ يَتَوَلَّ فَإِنَّ اللَّهَ هُوَ الْعَنِيُّ الْحَمِيدُ ﴿١٠﴾

لَقَدْ أَرْسَلْنَا رُسُلَنَا بِالْبَيِّنَاتِ وَأَنْزَلْنَا مَعَهُمُ  
الْكِتَابَ وَالْمِيزَانَ لِيَقُومَ النَّاسُ بِالْقِسْطِ ۗ  
وَأَنْزَلْنَا الْحَدِيدَ فِيهِ بَأْسٌ شَدِيدٌ وَمَنَافِعُ

të madh e fisnik, të cilin ai duhet ta përmbushë duke bërë përpjekje të mëdha, që të fitojë pëlqimin e Krijuesit dhe faljen e Tij.

7. Lexoni 3:134.

8. Fjala “Libër” në këtë ajet mund të nënkuptojë ligjin ose dijen Hyjnore. Mund të nënkuptojë gjithashtu edhe Kuranin. Sipas kuptimit të parë, domethënia e ajetit është se gjithçka i nënshtrohet një ligji të caktuar të natyrës. E sipas të dytit, kuptimi i ajetit mund të jetë që shkaqet dhe shërimet e fatkeqësive që hasin kombet apo individët, janë përmendur në Kuran. Fjalët “në tokë” u referohen kombeve e popujve, kurse ato “në jetën tuaj”, muslimanëve ose mbarë njerëzve si individë.

drejtësi. Dhe Ne zbritëm hekurin,<sup>9</sup> në të cilin ka mjete të fuqishme të luftës, gjithashtu edhe shumë dobi të tjera për njerëzit; që Allahu të dijë se kush e ndihmon Atë dhe të Dërguarit e Tij edhe kur është vetëm. Sigurisht, Allahu është i Plotfuqishëm, Mbizotërues.

27. Ne dërguam Nuhun dhe Ibrahimin, e pasardhësve të tyre u dhamë profetërinë dhe Librin. Prej tyre kishte nga ata që morën udhëzimin, por shumica prej tyre ishin të pabindur.<sup>10</sup>

28. Më pas dërguam vazhdimisht në gjurmët e tyre të Dërguarit Tanë (të tjerë). Më pas, dërguam edhe Isain birin e Merjemes dhe i dhamë Inxhilin. Në zemrat e atyre që e ndoqën atë, vumë dhembshuri e mëshirë; kurse murgërinë që ata vetë e bënë risi, nuk ua obliguam Ne, por (ne u kishim obliguar) vetëm kërkimin e pëlqimit të Allahut; ata nuk e ruajtën (murgërinë) siç duhej ruajtur ajo. Atyre që besuan prej tyre, Ne ua dhamë shpërblimin; dhe shumica prej tyre ishin të pabindur.<sup>11</sup>

لِّلنَّاسِ وَ لِيَعْلَمَ اللَّهُ مَن يُّضِرُّهُ وَ رُسُلَهُ  
بِالْغَيْبِ ۗ إِنَّ اللَّهَ قَوِيٌّ عَزِيزٌ ۝٩

وَ لَقَدْ أَرْسَلْنَا نُوحًا وَ إِبْرَاهِيمَ وَ جَعَلْنَا فِي  
ذُرِّيَّتِهِمَا الشُّبُهَةَ وَ الْكُتُبَ فَمِنْهُمْ مُّهُتَدٍ ۚ  
وَ كَثِيرٌ مِنْهُمْ فُسِقُونَ ۝١٧

ثُمَّ قَفَّيْنَا عَلَىٰ آثَارِهِم بِرُسُلِنَا وَقَفَّيْنَا  
بِعِيسَىٰ ابْنِ مَرْيَمَ وَ آتَيْنَاهُ الْإِنجِيلَ ۖ  
وَ جَعَلْنَا فِي قُلُوبِ الَّذِينَ اتَّبَعُوهُ رَأْفَةً  
وَ رَحْمَةً ۗ وَ رَهْبَانِيَّةً ابْتَدَعُوهَا مَا كَتَبْنَاهَا  
عَلَيْهِمْ إِلَّا ابْتِغَاءَ رِضْوَانِ اللَّهِ فَمَا رَعَوْهَا  
حَقَّ رِعَايَتِهَا ۚ فَآتَيْنَا الَّذِينَ آمَنُوا مِنْهُمْ  
أَجْرَهُمْ ۚ وَ كَثِيرٌ مِنْهُمْ فُسِقُونَ ۝١١

9. Lexoni parathënieën e sures.

10. Fjala “*fasik*” zakonisht përkthehet “i pabindur”, ose “i lig”, por ka kuptimin edhe “i devijuar”. Shikoni fjalorin “El-Munxhid”.

11. Në këtë ajet flitet për murgërinë që priftërinjtë e krishterë e praktikojnë duke mbetur të pamartuar gjithë jetën. Zoti nuk ua obligoi murgërinë, por i kishte porositur të ndiqnin rrugën e druajtjes ndaj Tij, porosi të cilën të krishterët e parë e ndoqën siç duhej, por ata që erdhën më vonë, duke e ekzagjeruar, sajuan zakonin e murgërisë. Realisht, shpërblimi i njeriut varet tërësisht nga fakti që njeriu të ketë një fuqi, por duke pasur drojë ndaj Zotit, të luftojë me ndjenjat negative të saj dhe të përfitojë nga dobitë e saj dhe kështu të fitojë shpërblim të dyfishtë. Por, çfarë shpërblimi mund të gëzojë ai që bëhet si fëmijë duke e çrënjosur fare këtë



29. O ju që besuat! Kini druajtje ndaj Allahut dhe besoni në të Dërguarin e Tij; Ai do t'ju japë dyfishin prej mëshirës së Tij, do t'ju japë një dritë, me të cilën ju do të ecni, dhe do t'ju falë. Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.<sup>12</sup>

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَآمِنُوا  
بِرَسُولِهِ يُؤْتِكُمْ كِفْلَيْنِ مِنْ رَحْمَتِهِ  
وَيَجْعَلْ لَكُمْ نُورًا تَمْشُونَ بِهِ  
وَيَغْفِرْ لَكُمْ وَاللَّهُ غَفُورٌ رَحِيمٌ ﴿٢٩﴾

30. Që ithtarët e Librit të mos mendojnë se (besimtarët) nuk zotërojnë asnjë pjesë në bekimin e Allahut, kurse, në të vërtetë, i gjithë bekimi është në dorën e Allahut, dhe Ai ia jep kujt të dojë. Allahu zotëron bekimin e madh.

لَيْلًا يَعْلَمَ أَهْلُ الْكِتَابِ أَلَّا يَقْدِرُونَ عَلَى  
شَيْءٍ مِّنْ فَضْلِ اللَّهِ وَأَنَّ الْفَضْلَ بِيَدِ اللَّهِ  
يُؤْتِيهِ مَن يَشَاءُ وَاللَّهُ ذُو الْفَضْلِ  
الْعَظِيمِ ﴿٣٠﴾

ndjenjë?! A mund të ketë ndonjë shpërblim fëmija për dëlirësinë e tij?! Dy ajete më parë, (në ajetin nr. 26) Zoti tha se bashkë me Profetët dhe Librat, ai dërgon edhe peshoren. Edhe kjo tregon që mësimet janë efikase kur janë të baraspeshuara. Ky ajet sjell provën për të treguar se çfarë ndodh nëse besimtarët nuk i përmbahen peshores.

12. Zoti thotë në këtë ajet që nëse i druheni Atij dhe nëse besoni në të Dërguarin e Tij, Ai do t'ju dhurojë diçka dalluese. Do t'ju japë një dritë e cila do t'ju shoqërojë kudo që të shkoni. Pra, kjo dritë do të jetë në veprat dhe në fjalët tuaja, në ndjenjat dhe në mendjen tuaj. Kudo që shkoni, këtë dritë do ta rrezatoni. Ky ajet tregon se *takvaja*, ose druajtja ndaj Zotit dhe injoranca nuk mund të bashkohen. Po, niveli i druajtjes mund të ndryshojë në bazë të kapacitetit të gjithsecilit. Ky ajet gjithashtu tregon se mrekullia më e madhe që u jepet njerëzve të Zotit, u jepet pikërisht për shkak të druajtjes së tyre dhe se ajo është kjo drita e Allahut. Pikërisht kjo dritë ua ndriçon zemrën dhe mendjen. Falë kësaj drite, edhe *keshfet* (vizionet) dhe ëndrrat e tyre bëhen kaq të qarta, që të tjerët nuk gëzojnë një gjë të tillë. Mbartësit e kësaj drite bëhen largpamës dhe atyre u dhurohen thesare të njohjes së Zotit. Në hadithe përmendet një lutje shumë emocionuese e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, një pjesë e së cilës është sa vijon: “O Allah! Bëj dritë në zemrën time, dritë në varrin tim, dritë para meje, dritë pas meje, dritë në të djathtën time, dritë në të majtën time, dritë mbi mua, dritë poshtë meje, dritë në dëgjimin tim, dritë në shikimin tim, dritë në flokët e mi, dritë në lëkurën time, dritë në mishin tim, dritë në gjakun tim dhe dritë në kockat e mia. O Allah! Më bëj të kuptoj rëndësinë e dritës, më dhuro dritë dhe më bëj mua dritë!” (Tirmidhi, nr. 3419).

## Surja 58 – El-Muxhadile

Surja El-Muxhadile është medinase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka njëzet e tri ajete.

Surja Muxhadile e ka si temë kryesore zakonin e arabëve, të cilët u drejtoheshin bashkëshorteve të tyre duke u thënë “nëna” për të shprehur pakënaqësinë dhe për t’u ndarë nga ato. Zoti i Madhërishëm e dënon këtë zakon të tyre duke thënë se nëna është ajo që ju ka lindur. Po kështu, u kërkon besimtarëve që të japin shpagim në rast se përfshihen në kotësi të tillë, dhe të ruhen nga zakone të tilla e të kthehen te bashkëshortet e tyre.

Surja El-Hadid përmendi hekurin, i cili përdoret për të prerë dhe për të çarë, por vetëm sendet, kurse surja El-Muxhadile në mënyrë të përsëritur përdor foljet “*juhaddun*” (kundërshtojnë ose çajnë me majë të mprehtë) “*hadd*” (çarës), gjë që u referohet çarjeve shpirtërore që njerëzit i shkaktojnë njëri-tjetrit. Në këtë kontekst, kjo sure thotë se ka disa njerëz që vazhdimisht ia lëndojnë shpirtin të Dërguarit të Allahut<sup>sav</sup>, dhe tentojnë të krijojnë ndasi midis sahabëve të tij, dhe për këtë punë, bëjnë komplete dhe biseda të fshehta, por në realitet ata bisedojnë vetëm për të shkatërruar veten e tyre. Thotë: Ata që lëndojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij përmes ironisë së tyre therëse, do të dështojnë, dhe se Allahu i Madhërishëm ka marrë përsipër që Ai dhe i Dërguari i Tij patjetër të triumfojnë.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Padyshim, Allahu ka dëgjuar fjalën e asaj që po debatonte me ty rreth të shoqit të vet dhe po i ankohej Allahut. Allahu po dëgjonte diskutimin e ju të dyve. Sigurisht, Allahu është Gjithëdëgjues, Gjithëshikues.

قَدْ سَمِعَ اللَّهُ قَوْلَ الَّتِي تُجَادِلُكَ فِي زَوْجِهَا وَتَشْتَكِي إِلَى اللَّهِ وَاللَّهُ يَسْمَعُ تَحَاوُرَكُمَا ۗ إِنَّ اللَّهَ سَمِيعٌ بَصِيرٌ ①

3. Prej jush ata që i quajnë bashkëshortet e tyre nëna (për t'u ndarë me to), ato nuk u bëhen nëna. Nënata e tyre janë vetëm ato që i lindën ata. Pa dyshim, ata thonë një fjalë të urryer dhe të gënjeshtërt. Dhe, sigurisht, Allahu është shumë Tolerant, shumë Falës.

الَّذِينَ يُظَاهِرُونَ مِنْكُمْ مِمَّن نَسَاهُمْ مَا هُنَّ أُمَّهَاتُهُمْ ۗ إِنَّ أُمَّهَاتُهُمْ إِلَّا الْإِنِّي وَلَدَنَّهُمْ ۗ وَاللَّهُ لَيَقُولُنَّ مُنْكَرًا مِنَ الْقَوْلِ وَرُؤُوسًا ۗ وَإِنَّ اللَّهَ لَعَفُوفٌ غَفُورٌ ①

4. Ata që i quajnë bashkëshortet e tyre nëna e më pas tërhiqen nga ajo që thanë, duhet të lirojnë një skllav përpara se (bashkëshortët) të prekin njëri-tjetrin. Kjo është ajo që ju këshillohet. Dhe Allahu është i Gjithinformuar për atë që bëni.

وَالَّذِينَ يُظَاهِرُونَ مِنْ نِسَائِهِمْ ثُمَّ يَعُودُونَ لِمَا قَالُوا فَتَحَرِيرٌ رَقَبَةٍ ۗ مِنْ قَبْلِ أَنْ يَتَمَاسَا ۗ ذِكْرُكُمْ تَوْعَظُونَ بِهِ ۗ وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرٌ ①

5. Ai që nuk ka mundësi (ta bëjë këtë), le të agjërojë dy muaj rresht, përpara se të prekin njëri-tjetrin. Dhe ai që nuk ka fuqi (as për këtë), le të ushqejë gjashtëdhjetë të varfër. Kjo është që ju të besoni në Allah dhe (në) të Dërguarin e Tij. Këta janë kufijtë e Allahut. Dhe për mohuesit ka ndëshkim të dhimbshëm.

فَمَنْ لَّمْ يَجِدْ فَصِيَامَ شَهْرَيْنِ مُتَتَابِعَيْنِ مِنْ قَبْلِ أَنْ يَتَمَاسَا ۗ فَمَنْ لَّمْ يَسْتَطِعْ فَاطْعَامَ سِتِّينَ مِسْكِينًا ۗ ذَلِكَ لِتُؤْمِنُوا بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ ۗ وَتِلْكَ حُدُودُ اللَّهِ ۗ وَاللَّكُفْرَيْنَ عَذَابٌ أَلِيمٌ ①

6. Ata që kundërshtojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij, edhe pse Ne kemi zbritur shenja të qarta, do të poshtërohen ashtu siç u poshtëruan ata që ishin para tyre. Dhe për mohuesit ka ndëshkim tejet poshtëruës.

7. Ditën kur Allahu do t'i ngrejë ata (si një grup) të tërë, do t'i informojë për atë që bënë; Allahu e ka shënuar, kurse ata e kanë harruar; dhe Allahu është Dëshmitar mbi çdo gjë.

8. A nuk e ke parë që Allahu di gjithçka që është në qiej dhe gjithçka që është në tokë?! Nuk bëhet ndonjë bisedë e fshehtë mes tre (njerëzve), që Ai të mos jetë i katërti i tyre; as mes pesë vetash, që Ai të mos jetë i gjashti i tyre; e as më pak e as më shumë se kaq, që Ai të mos jetë me ta kudo që të jenë ata. Pastaj, Ditën e Kiametit, Ai do t'i informojë për atë që bënë. Sigurisht, Allahu është i Gjithëdijshëm për çdo gjë.

9. A nuk i ke parë ata që u ishte bërë i ndaluar bisedimi i fshehtë, por ata e përsëritën të njëjtën gjë që u ishte bërë e ndaluar?! Ata bisedonin fshehtas për mëkatin, rebelimin dhe mosbindjen ndaj të Dërguarit. Dhe kur vijnë te ti, të përshëndesin në një mënyrë që Allahu nuk të ka përshëndetur ashtu; dhe thonë me veten e tyre: “Pse Allahu nuk na ndëshkon për këtë që themi?!” Për ta xhehenemi është i mjaftueshëm, në të cilin ata do të hidhen. Sa destinacion

إِنَّ الَّذِينَ يُحَادِّثُونَ اللَّهَ وَرَسُولَهُ كَبِتُوا  
كَمَا كَبِتَ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ وَقَدْ  
أَنْزَلْنَا آيَاتٍ بَيِّنَاتٍ وَلِلْكَافِرِينَ عَذَابٌ  
مُهِينٌ ﴿٦﴾

يَوْمَ يَبْعَثُهُمُ اللَّهُ جَمِيعًا فَيُنَبِّئُهُمْ بِمَا  
عَمِلُوا أَحْصَاهُ اللَّهُ وَسُوهُ ۗ وَاللَّهُ عَلَى  
كُلِّ شَيْءٍ شَهِيدٌ ﴿٧﴾

أَلَمْ تَرَ أَنَّ اللَّهَ يَعْلَمُ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا  
فِي الْأَرْضِ ۗ مَا يَكُونُ مِنْ نَجْوَى ثَلَاثَةٍ  
إِلَّا هُوَ رَابِعُهُمْ وَلَا خَمْسَةٍ إِلَّا هُوَ  
سَادِسُهُمْ وَلَا آدْنَى مِنْ ذَلِكَ وَلَا أَكْثَرَ  
إِلَّا هُوَ مَعَهُمْ آيِنٌ مَا كَانُوا ۗ ثُمَّ يُنَبِّئُهُمْ  
بِمَا عَمِلُوا يَوْمَ الْقِيَامَةِ ۗ إِنَّ اللَّهَ بِكُلِّ شَيْءٍ  
عَلِيمٌ ﴿٨﴾

أَلَمْ تَرَ إِلَى الَّذِينَ نُهُوا عَنِ النَّجْوَى ثُمَّ  
يَعُودُونَ لِمَا نُهُوا عَنْهُ وَيَتَنَجَّوْنَ بِالْأَثْمِ  
وَالْعُدْوَانِ وَمَعْصِيَتِ الرَّسُولِ ۗ وَإِذَا  
جَاءُوكَ حَيَّوْكَ بِمَا لَمْ يُحَيِّكَ بِهِ  
اللَّهُ ۗ وَيَقُولُونَ فِي أَنْفُسِهِمْ لَوْلَا يُعَذِّبُنَا  
اللَّهُ بِمَا نَقُولُ ۗ حَسْبُكُمْ جَهَنَّمُ ۗ يَصْلَوْنَهَا ۗ

i keq qenka ai!<sup>1</sup>

10. O ju që besuat, kur bëni biseda të fshehta, mos bisedoni për (të bërë) mëkat, rebelim dhe mosbindje ndaj të Dërguarit, por bisedoni për mirësi e druajtje! Kini druajtje ndaj Allahut, tek i cili do të mbliidheni.

11. Bisedimi i fshehtë (për të bërë mëkat, rebelim dhe mosbindje ndaj të Dërguarit) vjen pikërisht nga djalli, që ai t'i brengosë ata që besuan; dhe ai nuk mund t'i dëmtojë aspak, përveçse me lejen e Allahut. Andaj, vetëm tek Allahu duhet të mbështeten besimtarët.

12. O ju që besuat! Kur ju thuhet nëpër mbledhje: "Lironi vendin!", atëherë lironi vendin, Allahu do t'ju japë zgjerim; dhe kur ju thuhet: "Ngrihuni!", atëherë ngrihuni, Allahu do t'i lartësojë në grada ata që besuan prej jush, si dhe ata të cilëve u është dhënë dije. Allahu është i Gjithinformuar për atë që bëni.

13. O ju që besuat! Kur doni të këshilloheni me të Dërguarin (për ndonjë çështje personale), jepni lëshoshë përpara këshillimit tuaj. Kjo është më e mirë dhe më e pastër për ju. Dhe nëse nuk keni mundësi (për

فَبَسَّ الْمَصِيرُ ①

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا تَنَاجَيْتُمْ فَلَا تَتَنَاجَوْا بِالْإِثْمِ وَالْعُدْوَانِ وَمَعْصِيَتِ الرَّسُولِ وَتَنَاجَوْا بِالْبِرِّ وَالتَّقْوَى ۗ وَاتَّقُوا اللَّهَ الَّذِي إِلَيْهِ تُحْشَرُونَ ①

إِنَّمَا التَّجْوَى مِنَ الشَّيْطَانِ لِيَحْزَنَ الَّذِينَ آمَنُوا وَلَيْسَ بِضَارِّهِمْ شَيْئًا إِلَّا بِإِذْنِ اللَّهِ ۗ وَعَلَى اللَّهِ فَلْيَتَوَكَّلِ الْمُؤْمِنُونَ ①

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا قِيلَ لَكُمْ تَفَسَّحُوا فِي الْمَجَالِسِ فَافْسَحُوا يَفْسَحِ اللَّهُ لَكُمْ ۗ وَإِذَا قِيلَ انشُرُوا فَانشُرُوا يَرْفَعِ اللَّهُ الَّذِينَ آمَنُوا مِنْكُمْ ۗ وَالَّذِينَ أُوتُوا الْعِلْمَ دَرَجَاتٍ ۗ وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرٌ ①

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا نَاجَيْتُمُ الرَّسُولَ فَقَدِّمُوا بَيْنَ يَدَيْ نَجْوَاكُمْ صَدَقَةٌ ۗ ذَلِكَ خَيْرٌ لَّكُمْ وَأَظْهَرُ ۗ فَإِنْ لَّمْ تَجِدُوا

1. Ky ajet flet për bisedime të fshehta. Bisedimi i fshehtë nuk është mëkat, por nëse ai bëhet për padrejtësi, dhunë dhe për të bërë komplot kundër Allahut dhe të Dërguarit të Tij, është i ndaluar. Më tej, ajeti sqaron se për kë flet, pra për ata që në dukje e përhëndesin Profetin<sup>saws</sup>, por në zemër e shajnë dhe pastaj mendojnë që nuk ka asnjë ndëshkim për ta. Zoti i Madhërisëm ua di mirë zemrat dhe patjetër që do t'i ndëshkojë në xhehenem.

këtë), atëherë Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

فَإِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَحِيمٌ ﴿١٧﴾

14. A u frikësuar që të jepni lëmosha përpara këshillimit tuaj? Nëse nuk e keni bërë dot këtë, dhe Allahu ju ka falur, atëherë falni namazin, jepni zekatin dhe bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Allahu është i Gjithinformuar për atë që bëni.

ءَأَسْفَقْتُمْ أَنْ تَتَقَدَّمُوا بَيْنَ يَدَيْ نَجْوٰكُمْ  
صَدَقْتُمْ ۖ فَاذَلُمْ تَفْعَلُوا وَتَابَ اللَّهُ عَلَيْكُمْ  
فَأَقِيمُوا الصَّلٰوةَ وَآتُوا الزَّكٰوةَ وَأَطِيعُوا اللَّهَ  
رَسُولَهُ ۗ وَاللَّهُ خَبِيرٌ بِمَا تَعْمَلُونَ ﴿١٨﴾

15. A nuk i ke parë ata që i bënë miq njerëzit, me të cilët Allahu është i zemëruar?! Ata nuk janë as tuajt, e as të atyre, dhe betohen për gënjeshtren, edhe pse e dinë.

أَلَمْ تَرَ إِلَى الَّذِينَ تَوَلَّوْا قَوْمًا غَضِبَ  
اللَّهُ عَلَيْهِمْ ۖ مَا هُمْ مِنْكُمْ وَلَا مِنْهُمْ  
وَيَحْلِفُونَ عَلَى الْكُذِبِ وَهُمْ يَعْلَمُونَ ﴿١٩﴾

16. Allahu ka përgatitur ndëshkim të rëndë për ta. Është shumë e keqe ajo që ata bëjnë.

أَعَدَّ اللَّهُ لَهُمْ عَذَابًا شَدِيدًا ۗ إِنَّهُمْ سَاءَ  
مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿٢٠﴾

17. Betimet e tyre ata i bëjnë mburoja; pra, ata kanë penguar (të tjerët) nga rruga e Allahut, andaj do të kenë ndëshkim poshtërues.

إِتَّخَذُوا أَيْمَانَهُمْ جُنَّةً فَصَدُّوا عَن سَبِيلِ  
اللَّهِ فَ لَهُمْ عَذَابٌ مُّهِينٌ ﴿٢١﴾

18. As pasuritë e tyre dhe as fëmijët e tyre nuk do t'i shpëtojnë dot nga Allahu aspak! Pikërisht këta janë banorë të zjarrit, në të cilin do të mbesin gjatë.

لَنْ نُّغْنِيَ عَنْهُمْ أَمْوَالُهُمْ وَلَا أَوْلَادُهُمْ  
مِّنَ اللَّهِ شَيْئًا ۗ أُولَٰئِكَ أَصْحَابُ النَّارِ ۗ هُمْ  
فِيهَا خٰلِدُونَ ﴿٢٢﴾

19. Ditën kur Allahu do t'i ngrejë ata të gjithë, do të betohen para Tij njësoj siç betohen para jush, dhe do të mendojnë se bazohen te diçka. Dëgjoni! Pikërisht këta janë gënjeshtarë.

يَوْمَ يَبْعَثُهُمُ اللَّهُ جَمِيعًا فَيَحْلِفُونَ لَهُ  
كَمَا يَحْلِفُونَ لَكُمْ وَيَحْسَبُونَ أَنَّهُمْ عَلَى  
شَيْءٍ ۗ أَلَا إِنَّهُمْ هُمُ الْكٰذِبُونَ ﴿٢٣﴾

20. Djalli i ka bërë zap ata, andaj, ai i ka bërë ta harrojnë përmendjen e Allahut. Ky pikërisht është grupi i djallit. Dëgjoni! Pikërisht grupi i djallit do të jetë humbës.

اسْتَحْوَذَ عَلَيْهِمُ الشَّيْطَانُ فَأَنسَهُمْ ذِكْرَ  
اللَّهِ ۗ أُولَٰئِكَ حِزْبُ الشَّيْطَانِ ۗ أَلَا إِنَّ  
حِزْبَ الشَّيْطَانِ هُمُ الْخٰسِرُونَ ﴿٢٠﴾

21. Ata që kundërshtojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij, do të jenë ndër më të poshtëruarit.

إِنَّ الَّذِينَ يُحَادِّثُونَ اللَّهَ وَرَسُولَهُ أُولَٰئِكَ  
فِي الْأَدْلَىٰ ن ﴿٢١﴾

22. Allahu e ka shkruar: Unë dhe të Dërguarit e Mi patjetër do të triumfojmë! Sigurisht, Allahu është i Plotfuqishëm, Mbizotërues.<sup>2</sup>

كَتَبَ اللَّهُ لَأَعْلَبَنَ أَنَا وَرُسُلِي ۗ إِنَّ اللَّهَ  
قَوِيٌّ عَزِيزٌ ﴿٢٢﴾

23. Nuk do të gjesh njerëz që besojnë në Allah dhe (në) Ditën e Ahiretit, e të kenë miqësi me ata që armiqësohen me Allahun dhe të Dërguarin e Tij, edhe sikur ata të jenë baballarët e tyre, apo fëmijët e tyre, apo vëllezërit e tyre apo të fisit të tyre. Janë pikërisht këta, në zemrat e të cilëve Allahu ka shkruar besimin dhe i ka ndihmuar me Shpirtin prej Tij. Ai do t'i pranojë këta në xhenete nëpër të cilat rrjedhin lumenj; ata në to do të jetojnë përgjithmonë; Allahu është i kënaqur me ta dhe ata janë të kënaqur me Të.<sup>3</sup> Ky pikërisht

لَا تَجِدُ قَوْمًا يُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ  
الْآخِرِ يُوَادُّونَ مَنْ حَادَّ اللَّهَ وَرَسُولَهُ  
وَلَوْ كَانُوا آبَاءَهُمْ أَوْ أَبْنَاءَهُمْ أَوْ  
إِخْوَانَهُمْ أَوْ عَشِيرَتَهُمْ ۗ أُولَٰئِكَ كَتَبَ فِي  
قُلُوبِهِمُ الْإِيمَانَ وَأَيَّدَهُم بِرُوحٍ مِّنْهُ  
وَيُدْخِلُهُمْ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا  
الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا ۗ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمْ  
وَرَضُوا عَنْهُ ۗ أُولَٰئِكَ حِزْبُ اللَّهِ ۗ أَلَا إِنَّ

2. Folja në gjuhën arabe "ketebe" (shkruaj) në këtë ajet shënjon praktikën e përhershme të Zotit që Ai patjetër u sjell triumf të dërguarve të Tij. Vështirësitë që u vijnë në mes janë asgjë, edhe sikur ato t'ua bëjnë "tokën të ngushtë, pavarësisht nga gjerësia e saj" (9:118), përfundimisht, ata, pra të Dërguarit e Zotit triumfojnë. Robërit e Zotit kurrë nuk dështojnë. Ky premtim përmbushet pikërisht atëherë, kur mohuesit i kundërshtojnë të Dërguarit.

3. Sahabët e Profetit<sup>savs</sup> nuk hoqën dorë vetëm nga veprat e këqija, madje ata e flizuan jetën vetëm për të fituar pëlqimin e Zotit dhe braktisën rehatinë e tyre për t'u dhënë rehati njerëzve të botës, vetëm atëherë ata u formuan në një grup, në një xhemat besimtarësh, për të cilët Kurani i Shenjtë vërtetoi se ata bënë vepra të mira të atilla, që edhe Allahu ishte bërë i kënaqur

është grupi i Allahut. Dëgjoni!  
Pikërisht grupi i Allahut do të jetë i  
suksesshëm.<sup>4</sup>

يَا حِزْبَ اللَّهِ هُمُ الْمُفْلِحُونَ ﴿٢٨﴾

---

me ta, edhe ata ishin bërë të kënaqur me Allahun. Pa dyshim, kjo ishte fuqia bekuese e Profetit Muhammed<sup>savs</sup> që arriti ta përgatiste një xhemat të tillë me vlera kaq të larta. Kjo njëherësh i jep epërsi të madhe Profetit Muhammed<sup>savs</sup> që nuk ka pasur asnjë njeri tjetër që nga Hazret Ademi<sup>as</sup>.

4. “*Allahu u ka shkruar besimin në zemra*” do të thotë se besimi u ka hyrë në natyrën dhe në instinktet e tyre, saqë ata nuk kishin më nevojë për asnjë artificialitet. Kjo pozitë e lartë e besimit i jepet njeriut atëherë kur Zoti i dhuron një “jetë të re” përmes Shpirtit të Shenjtë. Ashtu siç shpirti qëndron në trup duke e mbajtur atë të gjallë, të ndriçuar dhe duke e rritur dhe edukuar, në të njëjtën mënyrë, Zoti ua dhuron besimtarëve të tillë të devotshëm Shpirtin e Shenjtë, i cili bashkëjeton me ta duke ua ndriçuar përherë zemrën. Pra, ashtu siç trupi jeton duke e pasur shpirtin brenda, aftësitë shpirtërore të tyre funksionojnë për shkak të Shpirtit të Shenjtë. Kjo është arsyeja që në këtë ajet Zoti i Madhërishtëm së pari tha se ua ka shkruar besimin në zemra, më pas tha: i ka ndihmuar me Shpirtin e Shenjtë. Sepse kur besimi iu shkrua në zemra dhe u ka hyrë në “ADN-në” e tyre, ata fituan një jetë të re, e cila nuk mund të lindte dhe nuk mund të rronte pa pasur ndihmën e Shpirtit të Shenjtë. Shpirti i Shenjtë quhet i tillë sepse Zoti pikërisht përmes tij ia dhuron njeriut një jetë të pastër. Kurani i Shenjtë ka plot ajete që flasin për jetën shpirtërore. Për shembull, diku ai pohon që pikërisht jeta që jetohej me besimin në Zot quhet jetë, kurse jeta e mohimit është “vdekje” (29:65). Edhe kjo tregon se Shpirti i Shenjtë ua mundëson jetën besimtarëve, kurse mohuesit, pavarësisht se janë të gjallë fizikisht, janë të privuar nga kjo jetë shpirtërore.



## Surja 59 – El-Hashr

Surja El-Hashr zbriti në Medinë dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka njëzet e pesë ajete.

Kjo sure edhe në fillim të saj përmend një grumbullim, edhe në fund të saj përmend një grumbullim tjetër shumë të madh. Grumbullimi i parë është ai që u quajt *evvelul-hashr*, dhe që u referohet atyre hebrenjve, të cilët janë ndëshkuar për shkak të shkeljeve dhe të pabesive të tyre. Secili prej tyre u ndëshkua sipas mëkateve të veta. Disa u dëbuan, disa u ndëshkuan me shkatërrimin e shtëpive të tyre dhe disa të tjerë u ekzekutuan. Pra, ky ishte grumbullimi i parë që qe për ndëshkimet. Edhe në fund të kësaj sureje përmendet një grumbullim tjetër, më i madhi, për të cilin thuhet se do të ndëshkohen ata që e harrojnë përmendjen e Allahut dhe, si rrjedhojë, harrojnë edhe vetë arsyen e ekzistencës së tyre, por në këtë grumbullim do të jenë edhe ata që gjithmonë e kujtojnë Allahun, dhe si rrjedhojë janë largpamës për veprat që dërgojnë për të ardhmen. Këta do të kenë një shpërblim madhështor.

Tema e përkujtimit të Allahut (*tesbih*) që vijon nga disa sure paraardhëse, dhe që përmendet edhe në fillim të kësaj sureje, duket se arrin *miraxhin*, pra kulmin e saj në fund të kësaj sureje, temë e cila fillon me fjalët “Ai është Allahu, përveç të cilit nuk ka të adhurueshëm tjetër” dhe numëron disa nga Emrat më madhështorë dhe më të bukur të Allahut. Duke pohuar se “Ai i ka Emrat më të bukur”, tha se Emrat e Tij, pra Cilësitë e Tij, nuk janë vetëm këta, por të Atij janë të gjithë Emrat e bukur.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Allahun e lartëson gjithçka që është në qiej dhe gjithçka që është në tokë; dhe Ai është Mbizotëruesi, i Urti.

سَبَّحَ لِلَّهِ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ ٢  
وَهُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ①

3. Është Ai që i nxori ata që mohuan nga ithtarët e Librit nga shtëpitë e tyre gjatë grumbullimit të parë. Ju nuk mendonit se ata do të dilnin, ndërkohë edhe ata mendonin se kështjellat e tyre do të jenë mbrojtësit e tyre nga Allahu. Atëherë Allahu u erdhi prej atje që ata nuk e imagjinonin, dhe vuri frikë në zemrat e tyre. Filluan t'i prishnin shtëpitë me duart e veta dhe me duart e besimtarëve.<sup>1</sup> Pra, merrni mësim, o largpamës!

هُوَ الَّذِي أَخْرَجَ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ أَهْلِ الْكِتَابِ مِنْ دِيَارِهِمْ لِأَوَّلِ الْحَشْرِ ٣ مَا ظَنَنْتُمْ أَنْ يَخْرُجُوا وَظَنُّوا أَنَّهُمْ مَانِعَتُهُمْ حُصُونُهُمْ مِنَ اللَّهِ فَأَتَهُمُ اللَّهُ مِنْ حَيْثُ لَمْ يَحْتَسِبُوا ٤ وَقَذَفَ فِي قُلُوبِهِمُ الرُّعْبَ يُخْرِبُونَ بُيُوتَهُمْ بِأَيْدِيهِمْ وَأَيْدِي الْمُؤْمِنِينَ ٥ فَاعْتَبِرُوا يَا أُولِيَ الْأَبْصَارِ ①

4. Allahu po të mos e kishte shkruar dëbimin për ta, do t'i ndëshkonte patjetër që në këtë botë. Dhe në *ahiret* ata do të kenë ndëshkimin e zjarrit.

وَلَوْ لَا أَنْ كَتَبَ اللَّهُ عَلَيْهِمُ الْجَلَآءَ لَعَذَّبَهُمْ فِي الدُّنْيَا ٦ وَلَهُمْ فِي الْآخِرَةِ عَذَابٌ النَّارِ ①

5. Kjo ndodhi sepse ata iu kundërvunë Allahut dhe të Dërguarit të Tij, dhe ai që i kundërvihet Allahut, (ta dijë) se Allahu është shumë i Fortë në ndëshkim.

ذَٰلِكَ بِأَنَّهُمْ شَاقُّوا اللَّهَ وَرَسُولَهُ ٧ وَمَنْ يُشَاقِقِ اللَّهَ فَإِنَّ اللَّهَ شَدِيدُ الْعِقَابِ ①

1. Bëhet fjalë për dëbimin e hebrenjve të fisit Benu Nedir.

6. Çdo hurmë që keni prerë ose që keni lënë të qëndronte mbi rrënjët e saj, e keni bërë me urdhrin e Allahut, dhe që Ai t'i poshtërojë të pabindurit.

7. Çka i fali Allahu të Dërguarit të Tij prej (pasurive të tyre) si plaçkë luftime, ju nuk rendët as kuaj e as deve për (ta fituar) atë, por Allahu ngarkon të Dërguarit e Tij mbi kë të dojë. Dhe Allahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë.

8. Dhe çka i fali Allahu të Dërguarit të Tij prej (pasurive të) banorëve të disa fshatrave si plaçkë luftime, ajo i takon Allahut, të Dërguarit, të afërmve, jetimëve, nevojtarëve dhe udhëtarëve; në mënyrë që kjo (pasuri luftime) të mos qarkullojë vetëm mes të pasurve prej jush. Çfarëdo që ju jep i Dërguari, merreni atë; dhe çfarëdo që ju ndalon ai, qëndroni larg saj. Dhe kini druajtje ndaj Allahut. Sigurisht, Allahu është shumë i Fortë në ndëshkim.

9. (Ajo pasuri u takon edhe) muhaxhirëve të varfër, të cilët u dëbuan nga shtëpitë dhe (u privuan nga) pasuritë e tyre; ata Allahut i kërkojnë bekim dhe pëlqim, dhe e ndihmojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Pikërisht këta janë të vërtetët.

10. Dhe ata që përgatitën shtëpitë që më parë, dhe (e kishin pranuar edhe) besimin, i donin (muhaxhirët) që mërgonin drejt tyre, duke mos pasur asnjë shtrëngim në kraharorë për atë

مَا قَطَعْتُمْ مِنْ لَيْنَةٍ أَوْ تَرَكْتُمُوهَا قَائِمَةً  
عَلَىٰ أَصْوِلِهَا فَبِإِذْنِ اللَّهِ وَ يُخْرِزِي  
الْفٰسِقِيْنَ ۝

وَمَا أَفَاءَ اللَّهُ عَلَىٰ رَسُولِهِ مِنْهُمْ فَمَا  
أَوْجَفْتُمْ عَلَيْهِ مِنْ خَيْلٍ وَلَا رِكَابٍ  
وَلَكِنَّ اللَّهَ يُسَلِّطُ رُسُلَهُ عَلَىٰ مَنْ يَشَاءُ  
وَاللَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ۝

مَا أَفَاءَ اللَّهُ عَلَىٰ رَسُولِهِ مِنْ أَهْلِ الْقُرَىٰ  
فَلِلَّهِ وَاللِّرَّسُولِ وَلِذِي الْقُرْبَىٰ وَالْيَتَامَىٰ  
وَالْمَسْكِينِ وَابْنِ السَّبِيلِ ۗ لَيْ لَا يَكُونَ  
دُولَةً بَيْنَ الْأَغْنِيَاءِ مِنْكُمْ ۗ وَمَا اتَّكُمُ  
الرَّسُولُ فَاخْذُوهُ ۗ وَمَا نَهَكُمُ عَنْهُ  
فَأَنْتَهُوا ۗ وَاتَّقُوا اللَّهَ ۗ إِنَّ اللَّهَ شَدِيدُ  
الْعِقَابِ ۝

وَالَّذِينَ

لِلْفُقَرَاءِ الْمُهَاجِرِينَ الَّذِينَ أُخْرِجُوا مِنْ  
دِيَارِهِمْ وَأَمْوَالِهِمْ يَبْتَغُونَ فَضْلًا مِنَ  
اللَّهِ وَرِضْوَانًا وَيَصْرُوهَ اللَّهُ وَرَسُولَهُ  
أُولَٰئِكَ هُمُ الصَّٰدِقُونَ ۝

وَالَّذِينَ تَبَوَّءُوا الدَّارَ وَالْإِيمَانَ مِنْ  
قَبْلِهِمْ يُحِبُّونَ مَنْ هَاجَرَ إِلَيْهِمْ وَلَا  
يَجِدُونَ فِي صُدُورِهِمْ حَاجَةً مِّمَّا أُوتُوا

që iu dhurohej (muhaxhirëve); dhe u jepnin përparësi të tjerëve para vetvetes edhe kur ishin ngushtë. Dhe pikërisht ata që shpëtojnë nga koprancia e vetvetes, janë të suksesshmit.

11. Dhe ata që erdhën pas tyre, thonë: “O Zoti ynë! Na fal ne dhe vëllezërit tanë paraardhës në besim dhe mos lërë aspak zili në zemrat tona ndaj atyre që besuan. O Zoti ynë! Pa dyshim, je shumë i Dhembshur, shumë Mëshirëbërës!”<sup>2</sup>

12. A nuk i ke parë hipokritët të cilët vëllezërve të tyre ithtarë të Librit që mohuan, u thoshin: “Nëse do të dëboheni ju, edhe ne patjetër do të dalim me ju, dhe kurrë nuk do t’i bindemi dikujt tjetër në lidhje me ju; dhe nëse do të sulmoheni, patjetër do t’ju ndihmojmë.” Allahu është Dëshmitar që ata janë gënjeshtarë.

13. Nëse ata dëbohen, këta nuk do dalin me ta, nëse ata sulmohen, këta nuk do t’i ndihmojnë dhe, edhe nëse do t’i ndihmojnë, do të ikin duke e kthyer shpinën, atëherë ata nuk do të ndihmohen.

وَيُؤْتِرُونَ عَلَىٰ أَنفُسِهِمْ وَلَوْ كَانَ بِهِمْ  
خَصَاصَةٌ ۗ وَمَنْ يُوقِ شُحَّ نَفْسِهِ فَأُولَٰئِكَ  
هُمُ الْمُفْلِحُونَ ﴿١١﴾

وَالَّذِينَ جَاءُوا مِنْ بَعْدِهِمْ يَقُولُونَ رَبَّنَا  
اغْفِرْ لَنَا وَ لِإِخْوَانِنَا الَّذِينَ سَبَقُونَا  
بِالْإِيمَانِ وَلَا تَجْعَلْ فِي قُلُوبِنَا غِلًّا لِلَّذِينَ  
آمَنُوا رَبَّنَا إِنَّكَ رَءُوفٌ رَحِيمٌ ﴿١٢﴾

أَلَمْ تَرَ إِلَى الَّذِينَ نَافَقُوا يَقُولُونَ  
لِإِخْوَانِهِمُ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ أَهْلِ  
الْكِتَابِ لَئِنْ أُخْرِجْتُمْ لَنَخْرُجَنَّ مَعَكُمْ  
وَلَا نُطِيعُ فِيكُمْ أَحَدًا أَبَدًا وَإِنْ قُوتِلْتُمْ  
لَنَنْصُرَنَّكُمْ ۗ وَاللَّهُ يَشْهَدُ إِنَّهُمْ  
لَكَاذِبُونَ ﴿١٣﴾

لَئِنْ أُخْرِجُوا لَا يَخْرُجُونَ مَعَهُمْ ۚ وَلَئِنْ  
قُوتِلُوا لَا يَنْصُرُونَهُمْ ۚ وَلَئِنْ نَصَرُوهُمْ  
لَيَكُونَنَّ الْأَدْبَارَ ۚ ثُمَّ لَا يَنْصُرُونَ ﴿١٤﴾

2. Ajetet 9 – 11 tregojnë besimin dhe shkallën e lartë shpirtërore të *ensarëve* dhe të *muhaxhirëve*. Njëherë një grup i *rafidinjve* të Irakut shkoi te *Hazret Imam Zejnul Abedini*<sup>ra</sup>. Ata i folën keq për *Hazret Ebu Bekrin*, *Hazret Omerin* dhe *Hazret Uthmanin r.anhum*. Ai i pyeti: “Ju a jeni nga *muhaxhirët* (që përmenden në ajetin nr. 9)”? “Jo” iu përgjigjën ata. “A jeni prej *ensarëve* (që përmenden në ajetin nr. 10)? Përsëri, “Jo” iu përgjigjën ata. “Atëherë unë dëshmoj që ju nuk jeni as prej atyre (që përmenden në ajetin nr. 11), për të cilët Zoti thotë: “Dhe ata që erdhën pas tyre, thonë: “O Zoti ynë! Na fal ne dhe vëllezërit tanë paraardhës në besim dhe mos lërë aspak zili në zemrat tona ndaj atyre që besuan ...” (Erbili, “Keshful-Gummeh”, f. 290)

14. Ju jeni më të fortë për të shkakuar frikë në zemrat e tyre, sesa Allahu. Kjo për arsye se ata janë njerëz që nuk mendojnë.

15. Ata nuk do të luftojnë me ju duke qenë të bashkuar, por vetëm në vendbanime të fortifikuara ose mbrapa mureve. Lufta e tyre mes vete është e fortë. Ti mendon se janë të bashkuar, ndërkohë zemrat e tyre janë të përçara. Kjo për arsye se ata janë njerëz që nuk kuptojnë.<sup>3</sup>

16. (Këta) janë si ata që ishin në të kaluarën e afërt dhe që shijuan pasojat e veprave të tyre. Dhe ata do të kenë ndëshkim të dhimbshëm.

17. Sikur shembulli i djallit, i cili i tha njeriut: “Moho!”, e kur ai mohoi, tha “unë jam i distancuar prej teje; unë i frikësohem Allahut, Zotit të botëve”.

18. Atëherë fundi i të dyve është që ata do të jenë në zjarr, ku do të mbesin gjatë. Ky pikërisht është ndëshkimi për keqbërësit.

19. O ju që besuat, kini druajtje ndaj Allahut! Çdo njeri duhet të shohë se çfarë ka siguruar për të nesërmen. Dhe kini druajtje ndaj Allahut! Sigurisht, Allahu është i Gjithinformuar për atë që bëni.

لَا تَنْتُمُ أَشَدَّ رَهْبَةً فِي صُدُورِهِمْ مِّنَ اللَّهِ ۗ ذَٰلِكَ بِأَنَّهُمْ قَوْمٌ لَا يَفْقَهُونَ ﴿١٩﴾

لَا يُقَاتِلُونَكُمْ جَمِيعًا إِلَّا فِي قُرَىٰ مُّحَصَّنَةٍ أَوْ مِنْ وَرَاءِ جُدُرٍ ۗ بَأْسُهُمْ بَيْنَهُمْ شَدِيدٌ ۗ تَحْسَبُهُمْ جَمِيعًا وَقُلُوبُهُمْ شَتَّىٰ ۗ ذَٰلِكَ بِأَنَّهُمْ قَوْمٌ لَا يَعْقِلُونَ ﴿٢٠﴾

كَمَثَلِ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ قَرِيبًا ذَاقُوا وَبَالَ أَمْرِهِمْ ۗ وَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿٢١﴾

كَمَثَلِ الشَّيْطَانِ إِذْ قَالَ لِلْإِنْسَانِ اكْفُرْ ۗ فَلَمَّا كَفَرَ قَالَ إِنِّي بَرِيءٌ مِّنكَ إِنِّي أَخَافُ اللَّهَ رَبَّ الْعَالَمِينَ ﴿٢٢﴾

فَكَانَ عَاقِبَتَهُمَا أَنَّهُمَا فِي النَّارِ خَالِدِينَ فِيهَا ۗ وَذَٰلِكَ جَزَاؤُ الظَّالِمِينَ ﴿٢٣﴾

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَتَنْظُرُوا نَفْسَ مَا قَدَّمْتُمْ لِغَدٍ ۗ وَاتَّقُوا اللَّهَ ۗ إِنَّ اللَّهَ خَبِيرٌ بِمَا تَعْمَلُونَ ﴿٢٤﴾

3. Kjo është një profeci për hebrenjtë që duket se do të përmbushet njësoj deri në Ditën e Kiametit. Derisa ata nuk gjejnë vende të mbrojtura e të fortifikuara, të cilat do të variojnë në bazë të çdo kohe, që të jenë të bindur se ata janë eprorët, deri atëherë kurrë nuk do të luftojnë me kundërshtarët e tyre. Por kjo nuk do të thotë se ata mes vete janë të bashkuar. Në dukje janë të bashkuar, por zemrat i kanë të përçara. Po kështu, edhe ata që janë në këtë kohë, të cilët Profeti Muhammed<sup>saws</sup> i ka quajtur të ngjashëm me hebrenjtë, janë po në këtë gjendje.

20. Dhe mos u bëni si ata që e harruan Allahun, atëherë Ai i bëri ta harrojnë veten e tyre. Pikërisht këta janë të pabindurit.

وَلَا تَكُونُوا كَالَّذِينَ نَسُوا اللَّهَ فَأَنْسَاهُمْ  
أَنْفُسَهُمْ ۗ أُولَٰئِكَ هُمُ الْفَٰسِقُونَ ﴿٢٠﴾

21. Nuk mund të barazohen njerëzit e zjarrit dhe njerëzit e xhenetit. Pikërisht njerëzit e xhenetit do të jenë të suksesshëm.

لَا يَسْتَوِي ۗ أَصْحَابُ النَّارِ وَأَصْحَابُ الْجَنَّةِ ۗ  
أَصْحَابُ الْجَنَّةِ هُمُ الْفَٰزِحُونَ ﴿٢١﴾

22. Sikur ta kishim zbritur këtë Kuran mbi ndonjë mal, ti patjetër do ta shikoje (malin) të përlurur (e) të copëtuar nga frika e Allahut. Këta janë shembuj që Ne i paraqesim për njerëzit, që ata të thellohen.<sup>4</sup>

لَوْ أَنْزَلْنَا هَٰذَا الْقُرْآنَ عَلَىٰ جَبَلٍ لَّرَأَيْتَهُ  
خَٰشِعًا مُّتَصَدِّعًا مِّنْ خَشْيَةِ اللَّهِ ۗ وَتِلْكَ  
الْأَمْثَالُ نَضْرِبُهَا لِلنَّاسِ لَعَلَّهُمْ  
يَتَفَكَّرُونَ ﴿٢٢﴾

23. Ai është Allahu, nuk ka të adhureshëm tjetër përveç Tij. I Dijshmi i së padukshmes dhe i së dukshmes. Ai është i Gjithë-mëshirshmi, Mëshirëbërësi.

هُوَ اللَّهُ الَّذِي لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ ۗ عِلْمُ الْغَيْبِ  
وَالشَّهَادَةِ ۗ هُوَ الرَّحْمَنُ الرَّحِيمُ ﴿٢٣﴾

24. Ai është Allahu, nuk ka të adhureshëm tjetër përveç Tij. Ai është Mbreti, i Shenjti, Paqja, Paqedhënësi, Strehuesi, Mbizotëruesi, Ndreqësi, Krenari. I

هُوَ اللَّهُ الَّذِي لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ ۗ أَمَلِكُ  
الْقُدُّوسِ السَّلَامِ الْمُؤْمِنِ الْمُهَيْمِنِ  
الْعَزِيزِ الْجَبَّارِ الْمُكْتَبِرِ ۗ سُبْحَانَ اللَّهِ

4. Kuptimi i këtij ajeti është që Kurani i Shenjtë ka një ndikim kaq të fuqishëm, saqë nëse do t'i zbritej ndonjë mali, mali do të copëtohej dhe do të rrafshohej me tokën. Pra, edhe sendet do të ndikoheshin kaq shumë nga efekti i tij, andaj, njerëzit që nuk përfitojnë nga ndikimet e tij të jashtëzakonshme, vetëm se e kanë privuar veten nga urtësia që sjell ai. Përveç kësaj, ky ajlet ka edhe një kuptim tjetër. Njeriu nuk mund të fitojë dashurinë dhe pëlqimin e Allahut, derisa nuk do të bëjë dy hapa të rëndësishëm: Së pari, "të thyejë" mendjemadhësinë e tij në mënyrë që koka kryeneçe të bjerë dhe të rrafshohet me tokën; pra, të largojë të gjitha mendimet që i vijnë nga mendjemadhësia që të përvetësojë përlulësinë. Dhe, së dyti, "të copëtojë" lidhjet e tij të vjetra. Njësoj si një gur që çahet dhe copëtohet në atë mënyrë që çdo pjesë e tij ndahet nga pjesa tjetër, edhe njeriu duhet të ndahet nga lidhjet e tij të këqija të mëparshme që i shkaktonin mospëlqimin e Zotit, dhe më pas takimet, dhe miqësitë e tij, dashuria dhe urrejtja e tij, të jenë për hir të Zotit.

Pastër është Allahu nga gjithçka që ata bëjnë ortak me Të.

عَمَّا يُشْرِكُونَ ﴿٢٤﴾

25. Ai është Allahu, Krijuesi, Filluesi, Formuesi. Ai i ka Emrat më të bukur. Atë e lartëson gjithçka që është në qiej e (në) tokë. Dhe Ai është Mbizotëruesi, i Urti.<sup>5</sup>

هُوَ اللَّهُ الْخَالِقُ الْبَارِئُ الْمَصَوِّرُ لَهُ  
الْأَسْمَاءُ الْحُسْنَىٰ ۖ يُسَبِّحُ لَهُ مَا فِي السَّمٰوٰتِ  
وَٱلْأَرْضِ ۗ وَهُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ﴿٢٥﴾

5. Ai Zot është Krijuesi i trupave, Krijuesi i shpirtave, Formuesi i njeriut në mitër, të gjithë emrat e bukur që mund të imagjinohen, i përkasin Atij. Dhe thotë: Edhe popujt e qiellit e përkujtojnë Atë me nderime, edhe popujt e Tokës. Ky ajet na jep shenjë që ka popuj edhe në trupa të tjerë qiellorë dhe se edhe ata janë të obliguar të zbatojnë udhëzimet e Zotit. Lexoni edhe 42:30; 65:13.

## Surja 60 – El-Mumtehine

Surja El-Mumtehine është zbritur në Medinë dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka katërmëdhjetë ajete.

Në suren paraardhëse u përmend *grumbullimi* i hebrejve, kurse në këtë sure, Allahu i Madhërishëm u tërheq vëmendjen muslimanëve: mos i bëni miq ata që armiqësohen me Allahun dhe të Dërguarin e Tij, pasi ata edhe nëse ju bëhen miq, ushqejnë ndjenja armiqësore për ju, dhe në çdo kohë planifikojnë si t'ju shkatërrojnë.

Pas kësaj, përmendet shembulli i *Hazret Ibrahim*<sup>as</sup>, i cili të gjitha miqësitë i kishte vetëm për hir të Allahut, dhe po për hir të Tij edhe armiqësitë. Andaj, nuk do t'ju ndihmojnë dot aspak as prindërit, as fëmijët, as të afërmit e as shokët tuaj, për sa kohë që ata mbeten armiq të Allahut. Juve ju duhet të vendosni lidhjet për hir të Allahut, dhe po për hir të Tij, t'i shkëputni ato. Megjithatë, Allahu i Madhërishëm gjithashtu i porositi muslimanët: Nuk keni asnjë të drejtë t'i dëmtoni kundërshtarët tuaj që nuk e kanë marrë nismën për t'ju dëmtuar ju. Po kështu, duhet të tregoni standardin më të lartë të drejtësisë, që, nëse të tjerët ruajnë miqësi me ju, edhe ju duhet të jeni miq me ta.

Kjo sure ngaqë flet për periudhën kur muslimanëve u ishte dhënë leje të luftojnë për vetëmbrojtje, jo vetëm me hebrejtë, por edhe me idhujtarët, andaj, shpjegon një sërë çështjesh që do të lindnin për shkak të luftës, se si muslimanët duhet të vepronin në këto raste. Për shembull, nëse gratë e idhujtarëve do të pranonin Islamin dhe do të vinin në Medinë duke mërguar, muslimanët t'ua testonin besimin për të siguruar nëse ato po e pranonin Islamin me vullnetin e tyre të lirë, dhe nëse po, muslimanët nuk duhet t'i kthenin ato te idhujtarët, pasi këta të fundit nuk ishin më të lejuar për to, megjithatë, t'u paguanin kujdestarëve të tyre ato që ata kishin shpenzuar për to.

Pasi ta bëjnë atë që u tha më sipër, Allahu i porositi muslimanët t'ua merrnin *bejatin* (betimin) grave që kishin ikur nga idhujtarët dhe kishin mërguar për t'iu bashkuar Islamit, dhe po kështu, t'ua merrnin *betimin* edhe grave të tjera muslimane.





1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. O ju që besuat! Armiqtë e Mi dhe armiqtë tuaj mos i bëni miq! Ju u shprehni dashurinë, kurse ata e kanë mohuar të vërtetën që juve ju erdhi; dëbojnë të Dërguarin dhe gjithashtu edhe ju (nga vatrata tuaja), vetëm sepse keni besuar Allahun, Zotin tuaj. Nëse keni dalë për të luftuar në rrugën Time dhe për të kërkuar pëlqimin Tim, njëkohësisht u jepni mesazhin e dashurisë, ndërkohë Unë e di më së miri çfarë e fshihni dhe çfarë e shfaqni, (është e kotë sjellja juaj). Dhe mes jush ai që e bën këtë, ka devijuar nga rruga e drejtë.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَتَّخِذُوا عَدُوِّي وَعَدُوَّكُمْ أَوْلِيَاءَ تُلْقُونَ إِلَيْهِم بِالْمَوَدَّةِ وَقَدْ كَفَرُوا بِمَا جَاءَكُمْ مِنَ الْحَقِّ يُخْرِجُونَ الرَّسُولَ وَإِيَّاكُمْ أَنْ تُؤْمِنُوا بِاللَّهِ رَبِّكُمْ ۗ إِنَّ كُفْرَكُمْ خَرَجْتُمْ جِهَادًا فِي سَبِيلِي وَابْتِغَاءَ مَرْضَاتِي ۗ تُسِرُّونَ إِلَيْهِم بِالْمَوَدَّةِ ۗ وَأَنَا أَعْلَمُ بِمَا أَحْفَيْتُمْ وَمَا أَعْلَنْتُمْ ۗ وَمَنْ يَفْعَلْهُ مِنْكُمْ فَقَدْ ضَلَّ سَوَاءَ السَّبِيلِ ①

3. Nëse ata do t'ju gjejnë, do të jenë armiq me ju, do të zgjasin me keqdashje drejt jush duart dhe gjuhët e tyre, dhe do të duan që edhe ju të ishit bërë mohues.

إِنْ يَتَفَقَّهُوْكُمْ يَكُونُوا لَكُمْ أَعْدَاءً وَبَيِّضُوا إِلَيْكُمْ أَيْدِيَهُمْ وَأَلْسِنَتَهُم بِالسُّوءِ وَوَدُّوا لَوْ تَكْفُرُونَ ①

4. As farefisi juaj e as fëmijët tuaj nuk mund t'ju sjellin dot dobi aspak Ditën e Kiametit. Ai do t'ju ndajë ju. Dhe Allahu është Gjithëshikues për atë që bëni.

لَنْ تَنْفَعَكُمْ أَرْحَامُكُمْ وَلَا أَوْلَادُكُمْ ۗ يَوْمَ الْقِيَامَةِ ۗ يَفْصَلُ بَيْنَكُمْ ۗ وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ بَصِيرٌ ①

5. Sigurisht, ju keni një model të shkëlqyer tek Ibrahim dhe tek ata që ishin me të; kur ata i thanë popullit të tyre: "Ne jemi të distancuar nga ju dhe nga ato që adhuroni në vend

قَدْ كَانَتْ لَكُمْ أُسْوَةٌ حَسَنَةٌ فِي إِبْرَاهِيمَ وَالَّذِينَ مَعَهُ ۗ إِذْ قَالُوا لِقَوْمِهِمْ إِنَّا بُرَآءُ مِنْكُمْ وَمِمَّا تَعْبُدُونَ مِنْ دُونِ

të Allahut; ne ju mohojmë ju, dhe mes nesh e jush (tashmë) u shfaqën armiqtësia dhe urrejtja përgjithmonë, derisa ju të besoni në Allahun e Vetëm”; me përjashtim të fjalës së Ibrahimit që i tha babait të vet: “Unë patjetër do të kërkoj falje për ty, edhe pse nuk kam aspak fuqi për ty përpara Allahut; “O Zoti ynë! Te Ti jemi mbështetur, drejt Teje jemi përlurur dhe po te Ti është kthimi!

6. O Zoti ynë! Mos na bëj sprovë për ata që mohuan, dhe, o Zoti ynë, na fal ne! Sigurisht, Ti je Mbizotëruesi, i Urti.”

7. Sigurisht, te ta keni një model të shkëlqyer, për çdokënd që shpreson Allahun dhe Ditën e Ahiretit. Dhe kushdo që e kthen shpinën, (ta dijë) se pikërisht Allahu është i Pavaruri, i Lavdishmi.

8. Mundet që Allahu të krijojë dashuri mes jush dhe atyre me të cilët keni armiqtësi. Allahu është i Plotfuqishëm, dhe Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

9. Allahu nuk ju ndalon t’u bëni mirësi e t’u bëni drejtësi atyre të cilët nuk luftuan kundër jush për fe dhe as nuk ju dëbuan nga shtëpitë tuaja. Sigurisht, Allahu i do ata që bëjnë drejtësi.<sup>1</sup>

اللَّهُ كَفَرْنَا بِكُمْ وَبَدَا بَيْنَنَا وَبَيْنَكُمُ  
الْعَدَاوَةُ وَالْبَغْضَاءُ أَبَدًا حَتَّى تُؤْمِنُوا بِاللَّهِ  
وَحَدَاهُ إِلَّا قَوْلَ إِبْرَاهِيمَ لِأَبِيهِ  
لَا سَعْفَرَنَ لَكَ وَمَا أَمْلِكُ لَكَ مِنَ  
اللَّهِ مِنْ شَيْءٍ ۗ رَبَّنَا عَلَيْكَ تَوَكَّلْنَا وَإِلَيْكَ  
أَبْنَاوَالِإِيكَ الْمَصِيرُ ۝

رَبَّنَا لَا تَجْعَلْنَا فِتْنَةً لِلَّذِينَ كَفَرُوا  
وَاعْفِرْ لَنَا رَبَّنَا ۗ إِنَّكَ أَنْتَ الْعَزِيزُ  
الْحَكِيمُ ۝

لَقَدْ كَانَ لَكُمْ فِيهِمْ أُسْوَةٌ حَسَنَةٌ لِّمَن  
كَانَ يَرْجُو اللَّهَ وَالْيَوْمَ الْآخِرَ ۗ وَمَن  
يَتَوَلَّ فَإِنَّ اللَّهَ هُوَ الْغَنِيُّ الْحَمِيدُ ۝

عَسَى اللَّهُ أَن يَجْعَلَ بَيْنَكُمْ وَبَيْنَ الَّذِينَ  
عَادَيْتُمْ مَوَدَّةً ۗ وَاللَّهُ قَدِيرٌ  
وَاللَّهُ عَفُورٌ رَّحِيمٌ ۝

لَا يَنْهَى اللَّهُ عَنِ الَّذِينَ لَمْ يُقَاتِلُوكُمْ  
فِي الدِّينِ وَلَمْ يُخْرِجُوكُمْ مِنْ دِيَارِكُمْ  
أَن تَبَرُّوهُمْ وَتُقْسِطُوا إِلَيْهِمْ ۗ إِنَّ اللَّهَ  
يُحِبُّ الْمُقْسِطِينَ ۝

1. Ky ajet kategorikisht hedh poshtë idenë e luftërave të dhunshme. Kurani i Shenjtë nuk i ndalon muslimanët të kenë mirësjellje e miqësi ndaj atyre jomuslimanëve që nuk kanë luftuar me ta për shkak të besimit ndryshe dhe që as nuk i kanë dëbuar nga vatrata e tyre.

10. Ai ju ndalon të bëni miq vetëm ata të cilët luftuan kundër jush për fe, ju dëbuan nga shtëpitë tuaja dhe bashkëpunuan për dëbimin tuaj. Ata që i bënë miq këta, patjetër janë keqbërës.

11. O ju që besuat! Kur ju vijnë besimtaret mërgimtare, testojini ato. Allahu e di më së miri besimin e tyre. E nëse mësoni që ato janë besimtare, mos i ktheni te mohuesit; ato nuk janë të lejuara për ta, e as ata nuk janë të lejuar për to; dhe jepuni (kujdestarëve të) tyre atë që ata shpenzuan. Dhe nuk ka gjynah për ju nëse martoheni me to, pasi t'u keni dhënë dhuratën e tyre të martesës. Mos i mbani nën kontroll lidhjet martesore të grave mohuese, dhe kërkoni atë që keni shpenzuar (për to, dhe), edhe ata le të kërkojnë (nga ju) atë që ata kanë shpenzuar. Ky është urdhri i Allahut për ju. Ai gjykon mes jush. Dhe Allahu është i Gjithëdijshëm, i Urtë.

12. Nëse ndokush nga gratë tuaja ju largohen për te mohuesit dhe ju e keni marrë dëmshpërblimin, atëherë atyre që u kanë ikur gratë, jepuni atë që ata shpenzuan. Dhe kini druajtje ndaj Allahut, të cilin ju e besoni.

إِنَّمَا يَهْتَكُمُ اللَّهُ عَنِ الَّذِينَ قَاتَلُوكُمْ فِي الدِّينِ وَأَخْرَجُوكُم مِّن دِيَارِكُمْ وَظَهَرُوا عَلَىٰ إِخْرَاجِكُمْ أَن تَوَلَّوهُمْ ۚ وَمَنْ يَتَوَلَّهُمْ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الظَّالِمُونَ ۝

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا جَاءَكُمُ الْمُؤْمِنَاتُ مُهَاجِرَاتٍ فَامْتَحِنُوهُنَّ ۗ اللَّهُ أَعْلَمُ بِإِيمَانِهِنَّ ۚ فَإِن عَلِمْتُمُوهُنَّ مُؤْمِنَاتٍ فَلَا تَرْجِعُوهُنَّ إِلَى الْكُفَّارِ لَأَهِنَّ حِلٌّ لَّهُمْ وَلَا هُمْ يَحِلُّونَ لَهُنَّ ۗ وَأَتَوْهُنَّ مَا أَنفَقُوا ۗ وَلَا جُنَاحَ عَلَيْكُمْ أَن تَنكِحُوهُنَّ إِذَا آتَيْتُمُوهُنَّ أَجُورَهُنَّ ۗ وَلَا تَمْسِكُوا بِعَصَمِ الْكُوفَارِ وَسَلُّوا مَا أَنفَقْتُمْ وَلَيْسَ لَكُم مَّا أَنفَقْتُمْ مِنْكُمْ حِكْمٌ ۗ وَاللَّهُ عَلِيمٌ حَكِيمٌ ۝

وَإِنْ فَاتَكُمْ شَيْءٌ مِّنْ أَرْوَاجِكُمْ إِلَى الْكُفَّارِ فَعَاقِبْتُمْ فَاتُوا الَّذِينَ ذَهَبَتْ أَرْوَاجُهُمْ مِّثْلَ مَا أَنفَقُوا ۗ وَاتَّقُوا اللَّهَ الَّذِي أَنْتُمْ بِهِ مُؤْمِنُونَ ۝

Disa komentues tentojnë të nxjerrin “argumentin” duke u bazuar te disa ajete të tjera se gjoja muslimanëve u është bërë e ndaluar miqësia me të gjithë jomuslimanët. Ky ajet qartazi u thotë të gjithë muslimanëve që me ata të cilët nuk kanë qenë të dhunshëm ndaj muslimanëve, jo vetëm që u lejohet të kenë miqësi, madje i porosit të kenë mirësjellje ndaj tyre. Lexoni edhe 5:52.

13. O Profet! Kur të vijnë besimtaret (dhe) bëjnë betimin me ty që asgjë nuk do të bëjnë ortak me Allahun, nuk do të vjedhin, nuk do të bëjnë tradhti bashkëshortore, nuk do të vrasin fëmijët e tyre, nuk do të bëjnë (ndaj askujt) shpifje duke sajuar përpara duarve e këmbëve të tyre, dhe nuk do të tregojnë mosbindje ndaj teje në (çështjet e) njohura, atëherë merrua betimin dhe kërkoji falje Allahut për to. Sigurisht, Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

14. O ju që besuat! Mos i bëni miq ata me të cilët Allahu është zemëruar. Ata kanë humbur shpresën nga *ahireti*, ashtu siç mohuesit kanë humbur shpresën nga ata që janë në varre.

يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ إِذَا جَاءَكَ الْمُؤْمِنَاتُ  
 يُبَايِعْنَكَ عَلَى أَنْ لَا يُشْرِكْنَ بِاللَّهِ شَيْئًا وَلَا  
 يَسْرِقْنَ وَلَا يَزْنِينَ وَلَا يَقْتُلْنَ أَوْلَادَهُنَّ  
 وَلَا يَأْتِينَ بِمَهْتَانٍ يَفْتَرِيَهُ بَيْنَ أَيْدِيهِنَّ  
 وَأَرْجُلِهِنَّ وَلَا يَعْصِيَنَّكَ فِي مَعْرُوفٍ  
 فَبَايِعْهُنَّ وَاسْتَغْفِرْ لَهُنَّ اللَّهُ ۗ إِنَّ اللَّهَ  
 غَفُورٌ رَحِيمٌ ﴿١٣﴾

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَتَوَلَّوْا قَوْمًا غَضِبَ  
 اللَّهُ عَلَيْهِمْ قَدْ يَسُؤُوا مِنَ الْآخِرَةِ كَمَا  
 نَبَّأُوا بِالنَّبِيِّينَ ۗ يَسُؤُونَ مِنَ الْقُبُورِ ﴿١٤﴾

## Surja 61 – Es-Saff

Surja Saff zbriti në Medinë dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka pesëmbëdhjetë ajete.

Në fund të sures së mëparshme u përmend *bejati*, pra betimi, i cili i ngarkon me përgjegjësi jo vetëm gratë besimtare, por edhe burrat besimtarë, që të zotohen se do të ruhen nga një sërë dobësish shpirtërore. Kurse në suren Es-Saff, u jepet porosi të dyve të mos dalin hipokritë në *betimin* e tyre, dhe të mos ndodhë që t'u predikojnë të tjerëve për të mirat por vetë të mos i zbatojnë. Allahu u thotë: Nëse do të jeni të sinqertë në *betimin* tuaj, Allahu do t'ju bashkojë zemrat aq fort, saqë përpara armikut ju do të bëheni si një mur i forcuar me bakër të shkrirë.

Po në këtë sure përmendet profecia e *Hazret Isai*<sup>as</sup> për Hazret Profetin Muhammed<sup>savs</sup>, profeci në të cilën përmendet emri tjetër i Profetit<sup>savs</sup>, pra “*Ahmed*”, që pasqyron aspektin e *hijeshisë* së Profetit<sup>savs</sup>. Në suren vijuese qartazi përmendet ardhja e dytë e Profetit Muhammed<sup>savs</sup> tek “të mëvonshmit” (*akharine*), profeci e cila do të lidhej pikërisht me *Ahmedin*. Këto sure hedhin dritë mbi kushtet në të cilat ai do të vinte, dhe shërbimet që do t'i bënte Islamit, së bashku me ndjekësit e tij, dhe që tregojnë qartazi se bëhej fjalë për një profeci madhështore për të ardhmen.

Në fund, kjo sure tregon sesi *Hazret Isai*<sup>as</sup> u bëri njoftimin njerëzve duke thënë – Kush mund të më ndihmojë në rrugën e Allahut? Dhe ngaqë vijnë profecitë e *Hazret Isai*<sup>as</sup>, është e domosdoshme që e njëjta ngjarje të ndodhë në *umetin* e Profetit Muhammed<sup>savs</sup> me grupin e “të mëvonshmëve”, në mënyrë që kur kjo thirrje do të bëhej për herë të dytë nga Mesihu që do të vinte në *umetin* e Muhammedit<sup>savs</sup>, muslimanët e sinqertë që besojnë në vërtetësinë e profecive, të bashkoheshin nën flamurin e Mesihut të Muhammedit duke thënë – Po, ne jemi ndihmëtarët e tu për mbështetjen e fesë së Muhammedit<sup>savs</sup>!



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Allahun e lartëson gjithçka që është në qiej dhe gjithçka që është në tokë. Dhe Ai është Mbizotëruesi, i Urti.

سَبَّحَ لِلَّهِ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ ٢  
وَهُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ②

3. O ju që besuat! Pse thoni atë që nuk e bëni?!

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لِمَ تَقُولُونَ مَا لَا تَفْعَلُونَ ③

4. Është mëkat i madh tek Allahu që të thoni atë që vetë nuk e bëni.

كَبْرًا مَقْتًا عِنْدَ اللَّهِ أَنْ تَقُولُوا مَا لَا تَفْعَلُونَ ④

5. Sigurisht, Allahu i do ata që luftojnë të rreshtuar në rrugën e Tij, sikur të jenë një mur i forcuar me bakër të shkrirë.

إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الَّذِينَ يُقَاتِلُونَ فِي سَبِيلِهِ صَفًّا كَأَنَّهُمْ بُنْيَانٌ مَرْصُوصٌ ⑤

6. Dhe (kujtoni) kur Musai i tha popullit të tij: “O populli im! Përse më lëndoni mua, edhe pse e dini që unë jam i Dërguari i Allahut për ju?!” Por kur ata bënë shtrembëri, Allahu ua shtrembëroi zemrat. Dhe Allahu nuk e udhëzon popullin e pabindur.

وَإِذْ قَالَ مُوسَى لِقَوْمِهِ يُقَوْمِ لِمَ تُوَدُّونَنِي وَقَدْ تَعْلَمُونَ أَنِّي رَسُولُ اللَّهِ إِلَيْكُمْ ٦  
فَلَمَّا زَاغُوا أَزَاغَ اللَّهُ قُلُوبَهُمْ ٧  
وَاللَّهُ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الْفَاسِقِينَ ⑥

7. Dhe (kujtoni edhe kohën) kur Isai biri i Merjemes tha: “O Bijtë e Izraelit! Unë jam i Dërguari i Allahut për ju, si vërtetues i asaj që keni përpara prej Teuratit dhe si sihariqdhënës për një të Dërguar që do të vijë pas meje; emri i tij është Ahmed”. Por kur ai u erdhi me shenjat e qarta, ata thanë:

وَإِذْ قَالَ عِيسَى ابْنُ مَرْيَمَ بَنِي إِسْرَائِيلَ إِنِّي رَسُولُ اللَّهِ إِلَيْكُمْ مُصَدِّقًا لِمَا بَيْنَ يَدَيَّ مِنَ التَّوْرَةِ وَمُبَشِّرًا بِرَسُولٍ يَأْتِي مِنْ بَعْدِي اسْمُهُ أَحْمَدٌ ٧

“Kjo qenka një magji e hapur!”<sup>1</sup>

8. E kush mund të jetë më keqbërës sesa ai që trillon gënjeshtren mbi Allahun, ndërkohë që ai thirret drejt Islamit?! Dhe Allahu nuk e udhëzon popullin keqbërës.

9. Duan të shuajnë dritën e Allahut me gojët e tyre, por Allahu do ta përsosë dritën e Tij, edhe sikur mohuesit ta urrejnë (këtë).

10. Është Ai që dërgoi të Dërguarin e Tij me udhëzimin dhe fenë e vërtetë, që ta bëjë atë t'i mbizotërojë të gjitha fetë, edhe sikur idhujtarët ta urrejnë (këtë).<sup>2</sup>

فَلَمَّا جَاءَهُمْ بِالْبَيِّنَاتِ قَالُوا هَذَا سِحْرٌ  
مُبِينٌ ﴿١٠﴾

وَمَنْ أَظْلَمُ مِمَّنِ افْتَرَى عَلَى اللَّهِ  
الْكَذِبَ وَهُوَ يُدْعَى إِلَى الْإِسْلَامِ وَاللَّهُ  
لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الظَّالِمِينَ ﴿١١﴾

يُرِيدُونَ لِيُطْفِئُوا نُورَ اللَّهِ بِأَفْوَاهِهِمْ  
وَاللَّهُ مَتِّمٌ نُورِهِ وَلَوْ كَرِهَ الْكَافِرُونَ ﴿١٢﴾

هُوَ الَّذِي أَرْسَلَ رَسُولَهُ بِالْهُدَى وَدِينِ  
الْحَقِّ لِيُظْهِرَهُ عَلَى الدِّينِ كُلِّهِ وَلَوْ كَرِهَ  
الْمُشْرِكُونَ ﴿١٣﴾

1. Në këtë ajet Zoti i Madhërishëm na sjell profecinë që flet për manifestimin e cilësisë Ahmed të Profetit Muhammed<sup>savs</sup>. Pra, Profeti<sup>savs</sup> u manifestua edhe me cilësinë e Muhammedit, gjë që e parashikoi Hazret Musai<sup>as</sup>, gjithashtu edhe me cilësinë e Ahmedit, gjë që e parashikoi Hazret Isai<sup>as</sup>.

2. Zoti i Madhërishëm në Kuranin e Shenjtë përmend dy misione të ndryshme të Profetit Muhammed<sup>savs</sup>: 1) Kompletimin e Librit, gjë që përfundoi me sukses që gjatë jetës së tij dhe vetë Zoti pohoi: “Sot, kam përsosur fenë tuaj për ju ...” (5:4) dhe 2) Përhapjen e mësimëve të Librit të Shenjtë në të gjithë botën, gjë që e thotë në këtë ajet duke pohuar “që ta bëjë atë t'i mbizotërojë të gjitha fetë” (61:10). Komentuesit e mëparshëm të Kuranit pohojnë se kjo profeci e dytë është e lidhur me ardhjen e Mesihut të Premtuar, sepse në kohën e tij Islami do të triumfojë mbi të gjitha fetë e tjera (lexoni Tefsir Kurtubij, Tefsir Taberi, etj., nën ajetin 61:09). Kjo sepse në kohën e Profetit Muhammed<sup>savs</sup> rrugët nuk ishin të hapura, mjetet e komunikimit nuk ishin në shkallën botërore, popujt nuk ishin njohur me njëri-tjetrin, madje një pjesë e botës as nuk ishte zbuluar. Kurse, koha në të cilën do të vinte Mesihu i Premtuar do të ishte kohë e globalizmit dhe e teknologjisë, kur jo vetëm që të gjitha fetë do të ishin të pranishme në arenë për të luftuar përmes argumenteve, por edhe ithtarët e çdo feje do të kishin edhe mundësinë dhe lehtësinë për të treguar pikëpamjet dhe argumentet e tyre. Kjo do të ishte koha kur e gjithë bota do të quhej një fshat global, siç nënkuptohet nga fjalët e këtij ajeti ku thotë “që ta bëjë fenë e vërtetë t'i mbizotërojë të gjitha fetë”. (Lexoni edhe suren 81). Shkurt, kjo kohë jona do të ishte pikërisht koha kur duhej të vinte Imam Mehdiu dhe Mesihu i Premtuar. (Më shumë për këtë temë, lexoni 32:6).

Në këtë ajet (61:10), Allahu i Madhërishëm ka përdorur dy fjalë “udhëzimi” (arab. “huda”) dhe “e vërteta” (arab. “hak”). Udhëzim do të thotë se ai (pra, i Dërguari) së pari do të ndreqë

11. O ju që besuat! A t'ju tregoj për një tregti që do t'ju shpëtojë nga një ndëshkim i dhimbshëm?

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا هَلْ أَدُلُّكُمْ عَلَىٰ تِجَارَةٍ  
تُنَجِّيْكُمْ مِنْ عَذَابِ أَلِيمٍ ⑩

12. Besoni në Allah dhe (në) të Dërguarin e Tij, dhe përpikuni në rrugën e Allahut me anë të pasurive dhe të jetëve tuaja. Kjo është më e mirë për ju, nëse e dini.

تُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ وَتُجَاهِدُونَ فِي  
سَبِيلِ اللَّهِ بِأَمْوَالِكُمْ وَأَنْفُسِكُمْ ۗ ذَٰلِكُمْ  
خَيْرٌ لَّكُمْ إِنْ كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ ⑪

13. (Allahu) do t'jua falë mëkatet dhe do t'ju shpjerë në xhenete nëpër të cilat rrjedhin lumenj; dhe (do t'ju shpjerë) në shtëpi të pastra në xhenete të përjetshme. Ky është suksesi madhështor.

يَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ ۗ وَ يُدْخِلْكُمْ جَنَّاتٍ  
تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ وَمَسْكَنَ طَيِّبَةً  
فِي جَنَّاتِ عَدْنٍ ۗ ذَٰلِكَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ ⑫

14. Dhe ka edhe një (lajm) tjetër, që e doni shumë –ndihmë prej Allahut dhe fitore të afërt. Jepu lajmin e mirë besimtarëve.

وَ أُخْرَىٰ تُجِيبُهَا ۗ نَصْرٌ مِنَ اللَّهِ وَفَتْحٌ  
قَرِيبٌ ۗ وَبَشِيرِ الْمُؤْمِنِينَ ⑬

15. O ju që besuat! Bëhuni ndihmës të Allahut, siç Isai biri i Merjemes u tha dishepujve: “Kush është ndihmësi im për tek Allahu?”, dishepujt thanë: “Ne jemi ndihmësit e Allahut!” Atëherë një grup prej bijve të Izraelit besoi, dhe një grup (tjetër) mohoi. Dhe Ne i ndihmuam ata që besuan kundër armiqve të tyre, atëherë ata triumfuan.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُونُوا أَنْصَارَ اللَّهِ كَمَا  
قَالَ عِيسَى ابْنُ مَرْيَمَ لِلْحَوَارِيِّينَ مَنْ  
أَنْصَارِي إِلَى اللَّهِ ۗ قَالَ الْحَوَارِيُّونَ نَحْنُ  
أَنْصَارُ اللَّهِ فَأَمَنْتَ طَائِفَةٌ مِنْ بَنِي  
إِسْرَائِيلَ وَكَفَرْتَ طَائِفَةٌ ۚ فَأَيَّدْنَا  
الَّذِينَ آمَنُوا عَلَىٰ عَدُوِّهِمْ فَاصْبَحُوا  
ظَهْرِينَ ⑭

gabimet e brendshme të *umetit* të muslimanëve përmes dritës dhe urtësisë me të cilën vjen prej Zotit, dhe kjo pikërisht ishte detyrë e Mehdiut (i Udhëzuar), kurse “e vërteta” nënkupton që ai do ta mundë gënjeshtren që qëndron jashtë *umetit*, siç për Profetin<sup>savs</sup>, në një ajet tjetër thotë “erdhi e vërteta dhe u zhdruk e rrema” (17:82). Kështu, edhe këtu Zoti pohon që ky i Dërguar vjen për t'i sjellë fitore së vërtetës. Por këtë fitore ai nuk do ta arrijë përmes shpatës apo pushkës, por përmes argumentit dhe lutjes. Ata që presin një Mehdi gjakatar se gjoja do t'u sjellë muslimanëve triumf përmes luftës me armë, janë në gabim të hapët dhe në kundërshtim me Kuranin që thotë “nuk ka imponim në fe” (2:257).



## Surja 62 – El-Xhumu’a

Surja El-Xhumu’a është zbritur në Medinë dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka dymbëdhjetë ajete.

Kjo sure i mbledh të gjitha profecitë që u përmendën në suren paraardhëse dhe zbërthen çdo kuptim të fjalës *xhumu’a* (mbledhje, bashkim). Profeti Muhammed<sup>savs</sup> do të bëhej shkak i bashkimit të të parëve me të mëvonshmit (*akharine*), dhe do t’i bashkonte kështu edhe manifestimet e *madhështisë* së tij, ashtu edhe manifestimet e *hijeshisë* së tij. Po kështu, kjo sure përmend edhe bashkimin e muslimanëve që bëhet çdo të premtë, pra çdo ditë xhumaje.

Në fund të kësaj sureje është bërë një profeci tjetër, që muslimanët e mëvonshëm do të mbeteshin në tregti dhe në kërkimin e pasurisë, duke e lënë të Dërguarin e Allahut<sup>savs</sup> tërësisht të vetëm. Për këtë ajet, disa komentues të Kuranit pohojnë se disa sahabë të tij, që nuk e linin Profetin<sup>savs</sup> të vetëm as në betejat më të rrezikshme, kur dëgjonin për ardhjen e ndonjë karvani tregtar, gjoja e linin të vetëm për të marrë përfitime materiale. Por kjo është vetëm një shpifje ndaj sahabëve të nderuar të Profetit<sup>savs</sup>. Në të vërtetë, ky ajet parashikon gjendjen e muslimanëve të periudhës së dytë, pra të të mëvonshmëve, të cilët praktikisht do ta harronin fenë e tyre, duke mos pasur lidhje shpirtërore me mesazhin e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Allahun e lartëson gjithçka që është në qiej dhe gjithçka që është në tokë; Sunduesin, të Shenjtin, Mbizotëruesin, të Urtin.

يُسَبِّحُ لِلَّهِ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ  
الْمَلِكِ الْقُدُّوسِ الْعَزِيزِ الْحَكِيمِ ①

3. Është Ai që dërgoi tek analfabetët një të Dërguar prej tyre; ai u reciton ajetet e Tij, i pastron dhe u mëson Librin dhe urtësinë, ndonëse ata deri më parë ishin në devijim të qartë;<sup>1</sup>

هُوَ الَّذِي بَعَثَ فِي الْأُمِّيِّينَ رَسُولًا مِنْهُمْ  
يَتْلُو عَلَيْهِمْ آيَاتِهِ وَيُزَكِّيهِمْ وَيُعَلِّمُهُمُ  
الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ ② وَإِنْ كَانُوا مِنْ قَبْلُ  
لِنَفْيِ ضَلَالٍ مُّبِينٍ ①

4. (Ai e dërgoi atë) edhe te të mëvonshmit prej tyre, të cilët ende nuk u janë bashkuar. Dhe Ai është Mbizotëruesi, i Urti.<sup>2</sup>

وَأَخْرَجَ مِنْهُمْ لِمَا يَدَّعُوا بِهِمْ ③ وَهُوَ  
الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ①

1. Ky ajet tregon veçorinë e pashoqe të Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, që besimtarëve të vet ai ua pastronte shpirtat duke u lexuar ajetet e Librit, përpara se t'ua jepte dijen dhe urtësinë e Librit. Në suren El-Bekare vjen lutja e Hazret Ibrahim<sup>as</sup>, që ai e bëri pikërisht për ardhjen e të Dërguarit të Allahut<sup>savs</sup>, por duke kërkuar që ai t'ua lexojë ajetet e Allahut, t'ua dhurojë dijen dhe urtësinë e me anë të tyre, t'ua bëjë pastrimin shpirtëror. Është mrekullia e Kuranit që Allahu i Madhërishëm përmend tri herë përmëshirën e lutjes së Ibrahimit, por të tria herët pastrimin shpirtëror e rendit menjëherë pas leximit të ajeteve dhe pastaj, mësimin e dijes dhe të urtësisë së Librit. Është veçantia e Kuranit të Shenjtë që edhe pse është zbritur përgjatë njëzet e tre vitesh, nuk gjen dot asnjë kundërtënie në ajetet e tij.

2. Në këtë ajet, Allahu i Madhërishëm përmend një grup të të mëvonshmëve (*akharine*), duke thënë se do ta dërgojë edhe te ta të njëjtin të Dërguar që u përmend në ajetin e mëparshëm. Po kështu, në ajetin e dytë të kësaj sureje, Allahu renditi katër cilësi të Tij, (Sunduesin, të Shenjtin, Mbizotëruesin, të Urtin), kurse në këtë ajet përsëriti vetëm dy të fundit, pra Mbizotëruesin dhe të Urtin. Kjo tregon se nuk do të vijë fizikisht i njëjti i Dërguar që u përmend më herët, por një shërbëtor ose pasqyrim i tij, i cili nuk do të sjellë Libër të ri. Është interesante që po këto dy cilësi që janë përmendur në këtë ajet, Allahu i Madhërishëm i ka përmendur në kontekstin e Hazret Isait<sup>as</sup>, ku tha: "por Allahu e ngriti drejt Vetes. Dhe Allahu është Mbizotëruesi, i Urtë" (4:159).

5. Ky është bekimi i Allahut, që Ai ia jep kujt të dojë. Dhe Allahu zotëron bekimin madhështor.<sup>3</sup>

ذٰلِكَ فَضْلُ اللّٰهِ يُؤْتِيهِ مَن يَّشَاءُ ۗ وَاللّٰهُ  
ذُو الْفَضْلِ الْعَظِيْمِ ۝

6. Shembulli i atyre që u ngarkuan me Teuratin e më pas nuk e mbartën atë, është si shembulli i gomarit që bart libra. Sa i keq është shembulli i atij populli, të cilët i quajtën gënjeshtër ajetet e Allahut! Dhe Allahu nuk e udhëzon popullin keqbërës.

مَثَلُ الَّذِيْنَ حُمِّلُوْا التَّوْرَةَ ثُمَّ لَمْ  
يَحْمِلُوْهَا كَمَثَلِ الْجَارِ يَحْمِلُ اَسْفَارًا ۗ  
بِئْسَ مَثَلُ الْقَوْمِ الَّذِيْنَ كَذَّبُوْا بِآيٰتِ اللّٰهِ  
وَاللّٰهُ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الظّٰلِمِيْنَ ۝

7. Thuaj: O ju që u bëtë judenj (hebrenj)!<sup>4</sup> Nëse pretendoni që nga të gjithë njerëzit vetëm ju jeni miqtë e Allahut, atëherë kërkojeni vdekjen, në qoftë se jeni të vërtetë!

قُلْ يٰۤاَيُّهَا الَّذِيْنَ هَادَوْا اِنْ رَّعَمْتُمْ اَنْفُسَكُمْ  
اَوْلِيَآءُ اللّٰهِ مِنْ دُوْنِ النَّاسِ فَتَمَنَّوْا  
الْمَوْتَ اِنْ كُنْتُمْ صٰدِقِيْنَ ۝

8. Ata kurrsezi nuk do ta kërkojnë vdekjen për shkak të asaj që duart e tyre kanë çuar përpara. Dhe Allahu është i Gjithëdijshëm për keqbërësit.

وَلَا يَتَمَنَّوْنَ اَبَدًاۗ بِمَا قَدَّمْتَ اَيْدِيْهِمْ ۗ  
وَاللّٰهُ عَلِيْمٌ بِالظّٰلِمِيْنَ ۝

3. Ky ajet provon që nuk bëhet fjalë për ardhjen e parë të Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, pasi nuk do të thuhej “Ai ia jep kujt të dojë”, por nënkupton ardhjen e tij të dytë që do të bëhej me ardhjen e një shërbëtori të tij, pra një profet brenda *umetit* të tij, dhe duke qenë i tillë, ai nuk thyen “Vulën e Profetëve” të Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, përkundrazi, vjen i vërtetuar me vulën e tij. Këtë tregojnë edhe fjalët në Buhari “ai do të jetë imami juaj prej jush” (Buhari, nr. 3449) dhe “ai do t’ju mësojë prej Librit tuaj dhe prej sunetit të Profetit tuaj” (Muslim, nr. 392 [155]). Kjo pozitë e lartë është bekimi i Allahut që Ai ia jep kujt të dojë dhe Ai zotëron bekimin madhështor. Këtë interpretim e mbështet vetë hadithi i Sahihut të Buhariut, në të cilin përmendet që kur u lexua ky ajet përpara sahabëve, ata e pyetën të Dërguarin e Allahut<sup>savs</sup>: “Cilët janë këta (të mëvonshmit), o i Dërguari i Allahut?”. Pra, ata nuk e pyetën se kush do të vijë, por te cilët do të vijë. Por Profeti<sup>savs</sup> heshti derisa ata e përsëritën tri herë të njëjtën pyetje. Vetëm atëherë ai u dha përgjigje se kush do të vijë. Ai vendosi dorën e tij mbi shpatullën e Hazret Selman Farisiut<sup>ra</sup> dhe tha: “Nëse besimi do të zhduket dhe do të shkojë edhe në Plejadat, një ose disa burra nga këta, do ta risjellin atë në tokë.” (Buhari, nr. 4897). Ky hadith e tregon qartazi se ajeti i Kuranit nuk flet për ardhjen fizike të vetë të Dërguarit të Allahut<sup>savs</sup>, por të një shërbëtori të tij të përsosur, i cili do të ishte me origjinë perse, pra joarabe.

4. Ithtarët e judaizmit ose jehudët.

9. Thuaj: Vdekja së cilës ju po i ikni, përnjëmend do t'ju zërë, më pas do të ktheheni tek i Dijshmi i së padukshmes dhe i së dukshmes, atëherë Ai do t'ju tregojë për atë që bënit.

10. O ju që besuat! Kur ju bëhet thirrje për namaz në ditën e premtë, nxitohuni për tek përkujtimi i Allahut dhe lëreni tregtinë. Kjo është më e mirë për ju, në qoftë se e dini.

11. E kur të përfundojë namazi, shpërndahuni në tokë, kërkon bekimet e Allahut dhe përkujtoni shumë Allahun, që të keni sukses.

12. Dhe kur ata shohin ndonjë tregti a dëfrim, vrapojnë drejt tij, duke të lënë ty në këmbë. Thuaj: Ajo që është tek Allahu është më e mirë se dëfrimi e tregtia. Dhe Allahu është Dhënësi më i mirë.

قُلْ إِنَّ الْمَوْتَ الَّذِي تَفِرُونَ مِنْهُ فَإِنَّهُ  
مُلَقِيكُمْ ثُمَّ تُرَدُّونَ إِلَىٰ عِلْمِ الْغَيْبِ  
﴿١﴾ وَالشَّهَادَةِ فَيُنبِّئُكُمْ بِمَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ ﴿٢﴾

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا نُودِيَ لِلصَّلَاةِ  
مِنْ يَوْمِ الْجُمُعَةِ فَاسْعَوْا إِلَىٰ ذِكْرِ اللَّهِ  
وَذَرُوا الْبَيْعَ ۗ ذٰلِكُمْ خَيْرٌ لَّكُمْ إِنْ كُنْتُمْ  
تَعْلَمُونَ ﴿٣﴾

فَإِذَا قُضِيَتِ الصَّلَاةُ فَانْتَشِرُوا فِي  
الْأَرْضِ وَابْتَغُوا مِنْ فَضْلِ اللَّهِ وَاذْكُرُوا  
اللَّهَ كَثِيرًا لَّعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ ﴿٤﴾

وَإِذَا رَأَوْا تِجَارَةً أَوْ لَهْوًا انفَضُّوا  
إِلَيْهَا وَتَرَكُوكَ قَائِمًا ۗ قُلْ مَا عِنْدَ اللَّهِ  
خَيْرٌ مِنَ اللَّهِوِ وَمِنَ التِّجَارَةِ ۗ وَاللَّهُ  
خَيْرُ الرَّزَاقِينَ ﴿٥﴾

## Surja 63 – El-Munafikun

Surja El-Munafikun është zbritur në Medinë dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka dymbëdhjetë ajete.

Kjo sure që në fillim tregon gjendjen e hipokritëve dhe thotë se ata betoheshin në Allah duke iu drejtuar Profetit – “Ti je i Dërguari i Allahut”, por Allahu e di shumë mirë që ti je i Dërguari i Tij, por se Allahu gjithashtu dëshmon që hipokritët po gënjejnë. Kjo gjithashtu tregon se në periudhën e *të mëvonshmëve* që u përmend në suren paraardhëse, një pjesë e madhe e muslimanëve do të jenë në këtë gjendje hipokrizie. Ata do të betoheshin për besimin e tyre në vërtetësinë e të Dërguarit të Allahut<sup>savs</sup>, por Allahu nga ana tjetër do të dëshmonte se betimet e tyre janë vetëm fjalë goje dhe nuk kanë asnjë lidhje me besimin e vërtetë.

Në këtë sure flitet edhe për kryehipokritin, Abdullah bin Ubej bin Selulin, i cili gjatë kthimit nga një betejë, kishte fyer të Dërguarin e Allahut<sup>savs</sup>, madje kishte pretenduar për veten e tij që të ishte njeriu më i nderuar i Medinës, dhe të kundërtën për të Dërguarin e Allahut<sup>savs</sup>, dhe si të tillë sipas tij, ai do ta dëbonte Profetin<sup>savs</sup> nga Medina sapo të ktheheshin. Ajo që ndodhi me caktimin e Allahut ishte krejt e kundërta. I Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> gëzoi fuqinë, pastaj jo vetëm që nuk e dëboi Abdullah bin Ubej bin Selulin në shenjë hakmarrjeje, por tregoi shembullin e pakundshoq të faljes dhe të mëshirës ndaj tij, dhe derisa hipokriti në fjalë vdiq, Profeti<sup>savs</sup> i kërkoi falje Zotit për mëkatet e tij. Më në fund, Allahu i Madhërishëm e ndaloi me urdhër të prerë Profetin<sup>savs</sup> që kurrë më të mos qëndronte te varri i tij duke kërkuar falje për të.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Kur hipokritët të vijnë ty, thonë: “Dëshmojmë se ti je i Dërguari i Allahut”, sigurisht, Allahu e di se ti je i Dërguari i Allahut, por gjithashtu Allahu dëshmon se hipokritët janë gënjeshtarë.

إِذَا جَاءَكَ الْمُؤْمِنُونَ قَالُوا نَشْهَدُ إِنَّكَ لَرَسُولُ اللَّهِ ۗ وَاللَّهُ يَعْلَمُ إِنَّكَ لَرَسُولُهُ ۗ وَاللَّهُ يَشْهَدُ إِنَّ الْمُؤْمِنِينَ لَكَاذِبُونَ ②

3. I përdorin betimet e tyre si mburojë, andaj i pengojnë (të tjerët) nga rruga e Allahut. Është shumë e keqe ajo që ata bëjnë.

إِتَّخَذُوا أَيْمَانَهُمْ جُنَّةً فَصَدُّوا عَنْ سَبِيلِ اللَّهِ ۗ إِنَّهُمْ سَاءَ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ③

4. Kjo ndodhi për shkak se ata besuan, pastaj mohuan, dhe kështu u janë vulosur zemrat, andaj ata nuk kuptojnë.

ذَلِكَ بِأَنَّهُمْ آمَنُوا ثُمَّ كَفَرُوا فَطَغَىٰ عَلَىٰ قُلُوبِهِمْ فَهُمْ لَا يَفْقَهُونَ ④

5. Kur i sheh ata, trupat e tyre të mahnitin; dhe nëse flasin, ti ua dëgjon fjalën; ata duken sikur drunj të qëndrueshëm; për çdo krismë (që kërcet) mendojnë se atyre do t'u bjerë. Ata janë armiqtë, andaj, ruhu prej tyre. Allahu i shkatërroftë! Ku po humbin ata!

وَإِذَا رَأَيْتَهُمْ تُعْجِبُكَ أَجْسَامُهُمْ ۗ وَإِنْ يَقُولُوا تَسْمَعُ لِقَوْلِهِمْ ۗ كَأَنَّهُمْ خُشْبٌ مُّسَدَّدٌ ۗ يَحْسَبُونَ كُلَّ صِخْرَةٍ عَلَيْهِمْ ۗ هُمُ الْعَدُوُّ فَاحْذَرهُمْ ۗ قَاتَلَهُمُ اللَّهُ ۗ أَلَىٰ يَوْمِكُمْ ⑤

6. Kur u thuhet: “Ejani, i Dërguari i Allahut do të kërkohë falje për ju!”, tundin kokat e tyre, dhe ti i sheh që stepen (nga rruga e vërtetë) duke u treguar mendjemëdhenj.

وَإِذَا قِيلَ لَهُمْ تَعَالَوْا يَسْتَغْفِرْ لَكُمْ رَسُولُ اللَّهِ لَوَّوْا رُءُوسَهُمْ وَرَأَيْتَهُمْ يَصُدُّونَ وَهُمْ مُسْتَكْبِرُونَ ⑥

7. Për ta është njësoj, në daç kërko falje, në daç mos kërko falje për ta. Kurrë nuk do t'i falë Allahu. Sigurisht, Allahu nuk e udhëzon popullin e pabindur.

8. Pikërisht këta janë që thonë: “Mos shpenzoni për ata që rrinë pranë të Dërguarit të Allahut, derisa të largohen!” Ndërkohë, të Allahut janë thesaret e qiejve e të tokës, por hipokritët nuk kuptojnë.

9. Thonë: “Nëse kthehemi në Medinë, më i nderuari patjetër do ta dëbojë më të poshttrin prej saj”, ndërkohë, i Allahut është nderi, i të Dërguarit të Tij dhe i besimtarëve, por hipokritët nuk dinë.

10. O ju që besuat! Pasuritë tuaja dhe fëmijët tuaj nuk duhet t'ju largojnë ju nga përkujtimi i Allahut. Ata që bien pre e një gjëje të tillë, janë humbësit.

11. Dhe shpenzoni nga ajo që Ne ju kemi dhënë, përpara se t'i vijë vdekja ndokujt prej jush, e ai të thotë: “O Zoti im! Sikur të më lëshoje pak afat, do të jepja lëmoshë dhe do të bëhesha ndër të dëlirët!”

12. Allahu kurrë nuk i jep kohë asnjë shpirti kur i vjen afati i tij. Dhe Allahu është i Gjithinformuar për atë që bëni.

سَوَاءٌ عَلَيْهِمْ أَسْتَغْفَرْتَ لَهُمْ أَمْ لَمْ  
تَسْتَغْفِرْ لَهُمْ ۗ لَنْ يَغْفِرَ اللَّهُ لَهُمْ ۗ إِنَّ اللَّهَ  
لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الْفَاسِقِينَ ﴿٧﴾

هُمُ الَّذِينَ يَقُولُونَ لَا تُنْفِقُوا عَلَيَّ مِنْ عِنْدِ  
رَسُولِ اللَّهِ حَتَّىٰ يُفْضَوْا ۗ وَلِلَّهِ خَزَائِنُ  
السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَلَكِنَّ الْمُنَافِقِينَ لَا  
يَفْقَهُونَ ﴿٨﴾

يَقُولُونَ لِنِ رَجَعْنَا إِلَى الْمَدِينَةِ لِيُخْرِجَنَا  
الْأَعْرَضُ مِنْهَا الْأَذَلُّ وَلِلَّهِ الْعِزَّةُ  
وَلِرَسُولِهِ وَلِلْمُؤْمِنِينَ وَلَكِنَّ الْمُنَافِقِينَ  
لَا يَعْلَمُونَ ﴿٩﴾

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تُلْهِكُمْ أَمْوَالُكُمْ  
وَلَا أَوْلَادُكُمْ عَنْ ذِكْرِ اللَّهِ ۗ وَمَنْ يَفْعَلْ  
ذَلِكَ فَأُولَئِكَ هُمُ الْخَاسِرُونَ ﴿١٠﴾

وَأَنْفِقُوا مِنْ مَّا رَزَقْنَاكُمْ مِنْ قَبْلِ أَنْ يَأْتِيَ  
أَحَدَكُمْ الْمَوْتُ فَيَقُولَ رَبِّ لَوْ لَا  
أَخَّرْتَنِي إِلَىٰ أَجَلٍ قَرِيبٍ ۗ فَأَصَدَّقَ  
وَأَكْفَنَ مِنَ الصَّالِحِينَ ﴿١١﴾

وَلَنْ يُؤَخِّرَ اللَّهُ نَفْسًا إِذَا جَاءَ أَجَلُهَا ۗ  
ۙ وَاللَّهُ خَبِيرٌ بِمَا تَعْمَلُونَ ﴿١٢﴾

## Surja 64 – Et-Tegabun

Surja Et-Tegabun është medinase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka nëntëmbëdhjetë ajete.

Sikurse surja El-Xhumu'a, edhe kjo sure fillon me fjalët “*Allahun e lartëson gjithçka që është në qiej dhe gjithçka që është në tokë*”. Pra, duke përmendur temën e përkujtimit të Allahut, kjo sure tregon se gjithçka që është në qiej e në tokë, e *lartëson* Allahun, dhe përkujtuesi më i madh i Tij është pikërisht Profeti Muhammed<sup>savs</sup>. Dhe nuk mund të ndodhë që Allahu të mos i zemërohet atij që e fyen përkujtuesin më të madh të Tij.

Për ditën e bashkimit ose të mbledhjes gjatë ditëve të vona që u përmend në Suren El-Xhumu'a, kjo sure jep parashikimin që ajo do të jetë edhe dita e rezultateve, e fitoreve dhe e humbjeve.

Ajo do të ishte dita ose epoka e sakrificave financiare me shumicë, andaj të gjithë sakrificëbërësve të tillë u jepet lajmi i mirë që gjithçka që ata shpenzojnë me sinqeritet në rrugën e Allahut, Allahu do t'ua pranojë dhe do t'i shpërblejë në mënyrë madhështore.





1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Allahun e lartëson gjithçka që është në qiej dhe gjithçka që është në tokë; i Atij është sundimi dhe e Atij është lavdia; Dhe Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë.<sup>1</sup>

يُسَبِّحُ لِلَّهِ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ ②  
لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ③

3. Është Ai që ju krijoi; andaj, prej jush ka edhe mohues dhe po prej jush ka edhe besimtarë. Allahu është Gjithëshikuesi i asaj që bëni.

هُوَ الَّذِي خَلَقَكُمْ فَمِنْكُمْ كَافِرٌ وَمِنْكُمْ مُؤْمِنٌ ④ وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ بَصِيرٌ ⑤

4. Ai krijoi qiejt dhe tokën me vërtetësi, ju dha trajtë, dhe sa trajtë të bukur ju dha. Tek Ai është kthimi.

خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ بِالْحَقِّ وَصَوَّرَكُمْ فَأَحْسَنَ صَوْرَكُمْ ⑥ وَإِلَيْهِ الْمَصِيرُ ⑦

1. Çdo grimcë e tokës dhe e qiellit dhe gjithçka që gjendet në to, e lartëson Zotin dhe përmend shenjtërinë e Tij. Atë e lartësojnë malet, e lartësojnë lumenjtë, e lartësojnë pemët, e lartësojnë dhe shumë nga njerëzit e sinqertë. Kurse ai që nuk e lartëson Atë me gojë e me zemër dhe që nuk përulet para Tij, caktimi i Tij e gjunjëzon përmes një sërë prangash e ndëshkimesh. Kurani pohon për engjëjt se ata që të gjithë i binden skajshmërisht Atij. Dhe të njëjtën gjë thotë edhe për të gjitha gjethet a grimcat e tokës, që çdo gjë e saj po i bindet Atij. Nuk bie asnjë gjethë, përveçse me lejen e Tij dhe as ndonjë ilaç mund të jetë shërues e as ndonjë ushqim mund të bëhet i dobishëm pa urdhrin e Tij. Pra, çdo gjë mban kokën të ulur me përulësi e robëri të skajshme te pragu i Tij, për t'iu bindur tërësisht Atij. Thërrmijat e dheut dhe të maleve, pikat e lumenjve dhe të oqeanëve, gjethet e pemëve dhe të shkurreve dhe çdo grimcë e njeriut dhe e kafshëve e njohin Zotin, i nënshtrohen Atij dhe e lavdërojnë dhe e madhërojnë Atë. Pra, ndër gjërat e tokës, disa prej tyre u binden urdhrave të Librit të Zotit, që është Libri i natyrës, e disa të tjera urdhrave të ligjeve që vijnë nga caktimi i Zotit, dhe ka edhe të tilla që u binden të dyjave. Qoftë reja, qoftë era, qoftë zjarri, qoftë dheu, të gjithë janë të angazhuar në bindje ndaj Zotit dhe në lartësimin e Tij. Nëse dikush nga njerëzit tregohet rebel ndaj urdhrave të Librit të Zotit, ai sërisht është i nënshtroar ndaj ligjeve të caktimit të Zotit. Askush nuk mund të dalë jashtë këtyre dy sundimeve. Çdokush është i detyruar t'i nënshtrohet të paktën njërit prej dy sundimeve qiellore. Po, herë pakujdesia, herë përkujtimi i Zotit e zotërojnë tokën për të përkeqësuar ose përmirësuar zemrat e njerëzve. Por pa urtësinë dhe organizimin e Zotit, nuk bëhen këto ndryshime. Zoti deshi që Toka të bëhet kështu, dhe ajo u bë. Lexoni edhe 57:2.

5. Ai e di atë që është në qiej e tokë, Ai e di atë që e fshihni, si dhe atë që e shfaqni. Allahu është i Gjithëdijshëm për atë që mbajnë kraharorët.

6. A nuk ju ka ardhur lajmi i atyre që mohuan më parë?! Ata e shijuan pasojën e vendimit të tyre dhe për ta do të ketë ndëshkim të dhimbshëm.

7. Kjo ndodhi për shkak se atyre u vinin të Dërguarit e tyre me shenjat e qarta, e ata thoshin: “Pse, njerëz do të na udhëzuan?” Atëherë ata mohuan dhe e kthyen shpinën, dhe (edhe) Allahu (u) tregoi se është i pavarur. Allahu është i Vetëmjaftueshëm, i Lavdishëm.

8. Ata që mohuan, menduan se nuk do të ringjallen. Thuaj: Përkundrazi! Për Zotin tim, ju patjetër do të ringjalleni, më pas do të njoftoheni për atë që bënit. Kjo për Allahun është shumë e lehtë.

9. Andaj, besoni Allahun, të Dërguarin e Tij dhe dritën që Ne e zbritëm! Allahu është i Gjithinformuar për atë që bëni.

10. Ditën kur Ai do t’ju tubojë për ditën e mbledhjes; ajo do të jetë dita e humbjeve dhe e fitoreve! Dhe ai që beson Allahun dhe bën të mira, (Allahu) do t’ia largojë të këqijat e tij dhe do ta çojë në xhenete, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. (Të tillët) në to do të jetojnë përgjithmonë. Ky është suksesi madhështor.

يَعْلَمُ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَيَعْلَمُ مَا تُسْرُونَ وَمَا تُعْلِنُونَ ۗ وَاللَّهُ عَلِيمٌ بِذَاتِ الصُّدُورِ ۝

أَلَمْ يَأْتِكُمْ نَبَأُ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ قَبْلُ ۖ فَذَاقُوا وَبَالَ أَمْرِهِمْ وَلَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ ۝

ذَٰلِكَ بِأَنَّهُ كَانَتْ تَأْتِيهِمْ رُسُلُهُمْ بِالْبَيِّنَاتِ فَعَالُوا أَكْثَرَ يَٰهْدُونَ ۗ فَكَفَرُوا وَتَوَلَّوْا وَاسْتَغْنَى اللَّهُ ۗ وَاللَّهُ غَنِيٌّ حَمِيدٌ ۝

رَعِمَ الَّذِينَ كَفَرُوا أَنْ لَنْ يُبْعَثُوا ۗ قُلْ بَلَىٰ وَرَبِّي لَتُبْعَثُنَّ ثُمَّ لَتُنَبَّؤُنَّ بِمَا عَمِلْتُمْ ۗ وَذَٰلِكَ عَلَى اللَّهِ يَسِيرٌ ۝

فَأْمِنُوا بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ وَالنُّورِ الَّذِي أَنْزَلْنَا ۗ وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرٌ ۝

يَوْمَ يَجْمَعُكُم يَوْمَ الْجَمْعِ ذَٰلِكَ يَوْمُ التَّعَابِينِ ۗ وَمَنْ يُؤْمِنْ بِاللَّهِ وَيَعْمَلْ صَالِحًا يُكْفِرْ عَنْهُ سَيِّئَاتِهِ وَيُدْخِلْهُ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا أَبَدًا ۗ ذَٰلِكَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ ۝

11. Dhe pikërisht ata që mohuan dhe i quajtën gënjeshtër ajetet Tona, do të jenë banorë të zjarrit, në të cilin do të mbesin gjatë. Sa destinacion i keq është ai!

وَالَّذِينَ كَفَرُوا وَكَذَّبُوا بِآيَاتِنَا أُولَٰئِكَ  
أَصْحَابُ النَّارِ خَالِدِينَ فِيهَا ۖ وَبِئْسَ  
الْمَصِيرُ ﴿١١﴾

12. Asnjë fatkeqësi nuk godet, pos me lejen e Allahut. Dhe Ai që beson në Allah, (Allahu) ia udhëzon zemrën. Allahu është i Gjithëdijshëm për çdo gjë.

مَا أَصَابَ مِنْ مُّصِيبَةٍ إِلَّا بِإِذْنِ اللَّهِ ۗ  
وَمَنْ يُؤْمِنْ بِاللَّهِ يَهْدِ اللَّهُ قَلْبَهُ ۗ وَاللَّهُ بِكُلِّ  
شَيْءٍ عَلِيمٌ ﴿١٢﴾

13. Bindjuni Allahut dhe bindjuni të Dërguarit! Nëse e ktheni shpinën, (dijeni se) i Dërguari Ynë është i ngarkuar vetëm me kumtimin e qartë.

وَاطِيعُوا اللَّهَ وَاطِيعُوا الرَّسُولَ ۚ فَإِنْ  
تَوَلَّيْتُمْ فَأِنَّمَا عَلَىٰ رَسُولِنَا الْبَلْغُ الْمُبِينُ ﴿١٣﴾

14. Allahu; nuk ka të adhurueshëm tjetër përveç Atij. Dhe tek Allahu duhet të mbështeten besimtarët.

اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ ۗ وَعَلَىٰ اللَّهِ فليتَوَكَّلِ  
الْمُؤْمِنُونَ ﴿١٤﴾

15. O ju që besuat! Sigurisht, ka (edhe) armiq prej bashkëshortëve dhe fëmijëve tuaj, andaj, ruhuni prej tyre. Nëse anashkaloni, toleroni e falni, atëherë (dijeni se) Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِنَّ مِنْ أَرْوَاحِكُمْ  
وَأَوْلَادِكُمْ وَعَدُوِّكُمْ فَاحْذَرُوهُمْ ۗ  
وَإِنْ تَعَفَوْا وَتَصَفَحُوا وَتَغْفِرُوا فَإِنَّ  
اللَّهَ غَفُورٌ رَّحِيمٌ ﴿١٥﴾

16. Në të vërtetë, pasuritë tuaja dhe fëmijët tuaj janë vetëm sprovë. Kurse tek Allahu ka shpërblim madhështor.<sup>2</sup>

إِنَّمَا أَمْوَالُكُمْ وَأَوْلَادُكُمْ فِتْنَةٌ ۗ وَاللَّهُ  
عِنْدَهُ أَجْرٌ عَظِيمٌ ﴿١٦﴾

2. Ajeti nuk do të thotë se fëmijët shkaktojnë sprovë haptazi apo me vetëdije për besimtarët, por do të thotë se njeriu sprovohet përmes familjes së tij, dhe ai që dështon në sprovë, bie në humbje. Fatmirësia e njeriut qëndron në besimin që ai t'i japë përparësi Zotit mbi çdo gjë dhe mbi çdokënd tjetër.

17. Andaj, kini druajtje ndaj Allahut sa të keni mundësi, dëgjoni, binduni e shpenzoni (në rrugën e Tij), (kjo) është më e mirë për ju. Dhe pikërisht ata që ruhen nga koprracia e vetvetes, janë të suksesshmit.

فَاتَّقُوا اللَّهَ مَا اسْتَطَعْتُمْ وَأَسْمِعُوا وَأَطِيعُوا  
وَأَنْفِقُوا خَيْرًا لِأَنْفُسِكُمْ ۗ وَمَنْ يُوقِ شُحَّ  
نَفْسِهِ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ ﴿١٧﴾

18. Nëse i jepni Allahut hua të mirë, Ai do t'ju shumëfishojë atë dhe do t'ju falë. Allahu është shumë Mirënjohës, shumë i Përmbajtur;

إِنْ تَقْرَضُوا اللَّهَ قَرْضًا حَسَنًا يُّضْعِفْهُ لَكُمْ  
وَيَغْفِرْ لَكُمْ ۗ وَاللَّهُ شَكُورٌ حَلِيمٌ ﴿١٨﴾

19. i Dituri i së padukshmes dhe i së dukshmes, Mbizotëruesi, i Urti.

يَعْلَمُ الْغَيْبِ وَالشَّهَادَةِ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ﴿١٩﴾

## Surja 65 – Et-Talak

Surja Et-Talak është medinase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka trembëdhjetë ajete.

Surja quhet Et-Talak, që do të thotë shkurorezim, ndarje bashkëshortore a divorc, dhe nga fillimi deri në fund, janë përmendur çështje të ndryshme të divorcit.

Një pikë qendrore e kësaj sureje që e lidh me suren e mëparshme, është edhe kjo që Profeti Muhammed<sup>savs</sup> është paraqitur si një dritë që i nxjerr njerëzit nga errësira në dritë. Pikërisht kjo dritë e tij do të shërbente në të njëjtën formë edhe te *të mëvonshmit* brenda *umetit* të tij, të cilët do të ishin të humbur në errësira. Dalja nga errësitat në dritë lidhet ngushtësisht me daljen nga mëkatet dhe mosbindjet dhe me hyrjen në një jetë shpirtërisht të pastër. Pra, ata nuk do të dilnin vetëm nga errësitat që lidhen me besimin, por edhe nga errësitat e veprave të këqija. Kështu që, kjo sure e quan Profetin Muhammed<sup>savs</sup> “kujtim” (*dhikr*), dhe pikërisht duke e përkujtuar Allahun, njeriu fiton dritë, siç edhe i Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> u bë dritë e plotë me bekimin e Zotit për shkak të përkujtimit, madje arriti t’i nxirrte dhe vazhdon t’i nxjerrë shërbëtorët e tij të sinqertë nga errësitat në dritë.

Ka një ajet në këtë sure që zbulon disa sekrete të habitshme të universit. Njësoj si Profeti Muhammed<sup>savs</sup> që nxjerr njerëzit nga errësitat në dritë, edhe Fjala e Allahut që iu shpall atij, zbulon sekrete të mëdha nga e padukshmja e universit. Në shumë sure të tjera, Kurani Famëlartë përmend shtatë qiej, kurse në këtë sure, bashkë me shtatë qiejt, përmend edhe shtatë toka. Allahu i Madhërishtëm e di më së miri se si u dhuroi banorëve të këtyre tokave komunikimin e Tij, pra shpalljen Hyjnore, dhe se nga çfarë lloje errësirash i nxori edhe ata në dritë. Në këtë kohë, shkencëtarët që kërkojnë jetë jashtëtokësore, nuk kanë arritur dot as fillimin e kësaj teme, por siç u provua shumë herë, dijet që burojnë nga Kurani i Shenjtë janë pors *keutheri*, një oqean i pafund dijesh, dhe shkencëtarët e së ardhmes do të njoftohen deri diku edhe në këtë drejtim.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. O Profet! Kur (ju besimtarët) divorconi gratë, divorcojini duke respektuar afatin e tyre (të divorcit), dhe llogariteni afatin e pritjes. Dhe kini druajtje ndaj Allahut, Zotit tuaj! Mos i dëboni ato nga shtëpitë e tyre dhe as ato të mos dalin, përveçse nëse bëjnë ndonjë paturpësi të hapët. Këta janë kufijtë e Allahut, dhe kushdo që i shkel kufijtë e Allahut, i bën keq vetvetes. Ti nuk di që ndoshta Allahu do të tregojë pas kësaj ndonjë vendim (të ri).<sup>1</sup>

يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ إِذَا طَلَقْتُمُ النِّسَاءَ فَطَلِقُوهُنَّ  
لِعَدَّتِهِنَّ وَأَحْصُوا الْعِدَّةَ ۚ وَاتَّقُوا اللَّهَ  
رَبَّكُمْ ۚ لَا تُخْرِجُوهُنَّ مِنْ بُيُوتِهِنَّ وَلَا  
يَخْرُجْنَ إِلَّا أَنْ يَأْتِيَنَّ بِفَاحِشَةٍ مُّبِينَةٍ ۗ  
وَتِلْكَ حُدُودُ اللَّهِ ۗ وَمَنْ يَتَعَدَّ حُدُودَ  
اللَّهِ فَقَدْ ظَلَمَ نَفْسَهُ ۗ لَا تَدْرِي لَعَلَّ  
اللَّهُ يُحْدِثُ بَعْدَ ذَلِكَ أَمْرًا ①

3. Andaj, kur ato e arrijnë afatin e tyre të pritjes, ose mbajini me rregullsi, ose ndahuni prej tyre me rregullsi; dhe caktoni si dëshmitarë dy (njerëz) të drejtë mes jush, dhe vendosni dëshminë për Allahun. Kjo është ajo që ju këshillohet, për çdokënd që beson në Allah dhe në Ditën e Ahiretit; dhe ai që i druhet Allahut, (Allahu) i gjen ndonjë rrugëdalje,

فَإِذَا بَلَغْنَ أَجَلَهُنَّ فَأَمْسِكُوهُنَّ بِمَعْرُوفٍ  
أَوْ فَارِقُوهُنَّ بِمَعْرُوفٍ وَ اشْهَدُوا ذَوَى  
عَدْلٍ مِّنْكُمْ وَاقْبِلُوا الشَّهَادَةَ لِلَّهِ ۗ ذَٰلِكُمْ  
يُوعِظُ بِهِ مَنْ كَانَ يُؤْمِنُ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ  
الْآخِرِ ۗ وَمَنْ يَتَّقِ اللَّهَ يَجْعَلْ لَهُ  
مَخْرَجًا ①

4. dhe e ushqen nga atje që ai nuk e imagjinoi dot. Dhe një që mbështetet tek Allahu, (ta dijë se) Ai

وَ يَرْزُقْهُ مِنْ حَيْثُ لَا يَحْتَسِبُ ۗ وَمَنْ  
يَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ فَهُوَ حَسْبُهُ ۗ إِنَّ اللَّهَ

1. Pjesa e fundit e ajetit mund t'i drejtohet edhe atij që ka vendosur t'i japë divorc gruas së tij. Duke e kushhtëzuar atë me kufijtë e Allahut, këto fjalë i japin mësim që mundet që gjatë pritjes për të plotësuar afatin e divorcit, Allahu i Madhërisëm të shfaqë diçka të re për bashkëshortët, në mënyrë që ata të tërhiqen nga divorci.

është i mjaftueshëm për të. Sigurisht, Allahu e plotëson vendimin e Tij. Për çdo gjë Allahu ka caktuar një masë.<sup>2</sup>

5. Dhe gratë tuaja të cilave u janë ndërprerë menstruacionet, nëse dyshoni (për afatin e tyre), atëherë afati i tyre i pritjes është tre muaj, po kështu edhe i atyre që nuk patën menstruacionet.<sup>3</sup> Për sa u përket shtatzënave, afati i tyre i pritjes është derisa të lirohen nga barra e tyre. Ai që i druhet Allahut, (Allahu) i krijon lehtësi me urdhrin e Tij.

6. Ky është urdhri i Allahut që Ai ju ka zbritur juve. Dhe Ai që i druhet Allahut, (Allahu) ia largon të këqijat, dhe i shton shumë shpërblimin.

7. Vendosini ato ku banoni edhe ju sipas mundësisë suaj dhe mos i vështirësoni duke ua shtrënguar jetën. E nëse ato janë shtatzëna, vazhdoni të shpenzoni për to gjersa të lirohen nga barra e tyre. Më pas, nëse i japin gji fëmijës suaj,

2. Në kontekstin e divorcit, ajeti thotë: nëse do të keni frikë ndaj Zotit, pra, nëse nuk nxitoheni për të marrë vendimin e divorcit dhe nuk këmbëngulni për diçka të pabazë, Zoti do t'ju largojë vështirësitë dhe do t'ju furnizojë nga atje që nuk e imagjinoni dot. Përveç kësaj, besimtari gjithmonë duhet të analizojë veten e tij se sa ka përparuar ai në dëlirësi dhe në druajtje ndaj Zotit. Kriteri për ta parë këtë është Kurani. Zoti thotë se Ai ka vendosur një shenjë për besimtarin, që e largon atë nga veprat e papëlqyera të dynjasë, duke u bërë i Mjaftueshëm për të. Pra, shenja e besimtarit që ka druajtje ndaj Zotit është që ai nuk mbetet nevojtar dhe i varur ndaj ligësive dhe punëve të papëlqyeshme. Për shembull, një tregtar mendon se pa gënjyer klientin, s'mund të bëjë tregti, andaj e gënjen dhe gënjeshtren e paraqet si nevojë. Por besimtarin e vërtetë që ka druajtje ndaj Zotit, Zoti e mbron nga nevoja të tilla. E vërteta është që kur njeriu e lë Zotin, edhe Zoti e lë atë, dhe kur *Rrahmani* (i Gjithëmëshirshmi) e lë atë, shejtani (djalli) krijon lidhje me të.

3. D.m.th. ato që nuk patën menstruacionet në një periudhë të caktuar për shkak të shkaqeve a sëmundjeve të ndryshme.

بَالِغِ أَمْرِهِ<sup>ط</sup> قَدْ جَعَلَ اللَّهُ لِكُلِّ شَيْءٍ  
قَدْرًا ۝

وَالَّذِي يَسْنَنَ مِنَ الْمَحِيضِ مِنْ نِسَائِكُمْ إِنْ  
ارْتَبْتُمْ فَعِدَّتُهُنَّ ثَلَاثَةَ أَشْهُرٍ<sup>ل</sup> وَالَّذِي لَمْ  
يَحْضَنْ<sup>ط</sup> وَأَوْلَاتِ الْأَحْمَالِ أَجَلُهُنَّ أَنْ  
يَضَعْنَ حَمْلَهُنَّ<sup>ط</sup> وَمَنْ يَتَّقِ اللَّهَ يَجْعَلْ  
لَهُ مِنْ أَمْرِهِ يُسْرًا ۝

ذَلِكَ أَمْرُ اللَّهِ أَنْزَلَهُ إِلَيْكُمْ<sup>ط</sup> وَمَنْ يَتَّقِ  
اللَّهَ يَكْفُرْ عَنهُ سَيِّئَاتِهِ وَيُعْظِمْ لَهُ أَجْرًا ۝

أَسْكُنُوهُنَّ مِنْ حَيْثُ سَكَنْتُمْ مِنْ وُجْدِكُمْ  
وَلَا تَضَارُّوهُنَّ يَتَضَيَّقُوا عَلَيْهِنَّ<sup>ط</sup> وَإِنْ كُنَّ  
أَوْلَاتٍ حَمَلٌ فَانْفِقُوا عَلَيْهِنَّ حَتَّى يَضَعْنَ  
حَمْلَهُنَّ<sup>ع</sup> فَإِنْ أَرْضَعْنَ لَكُمْ فَاتُّوهُنَّ

jepuani shpërblimin e tyre. Krijoni mirëkuptim mes jush sipas rregullit. Nëse ndokush ndien shtrëngesë (dhe nuk arrin të ketë mirëkuptim), fëmijës së tij le t'i japë gji ndonjë grua tjetër.

8. Duhet që i pasuri të shpenzojë sipas pasurisë së tij. Kurse atij që i është shtrënguar jetesa, le të shpenzojë nga ajo që i ka dhënë Allahu. Allahu nuk ngarkon asnjë shpirt përtej asaj që Ai i ka dhënë atij. Allahu patjetër sjell lehtësim pas vështirësisë.

9. Sa shumë vendbanime ishin që iu kundërvunë urdhrit të Zotit të tyre si dhe të të Dërguarve të Tij! Atëherë, Ne u kërkuam llogari shumë të rreptë dhe i ndëshkuam me një ndëshkim të rëndë.

10. Ato e shijuan pasojën e vendimit të tyre, dhe pasoja e vendimit të tyre qe vetëm humbje.

11. Allahu u ka përgatitur një ndëshkim të rëndë, andaj kini druajtje, o ju të mençur që pranuat besimin. Sigurisht, Allahu ka zbritur për ju një Kujtim,

12. një të Dërguar,<sup>4</sup> që ju reciton

أَجُورَهُنَّ ۚ وَاتَّمَرُوا بَيْنَكُمْ بِمَعْرُوفٍ ۚ  
وَإِنْ تَعَاَسَرْتُمْ فُسْتُرُضِعْ لَهُ الْآخَرَىٰ ۖ

لِيُنْفِقَ ذُو سَعَةٍ مِّن سَعَتِهِ ۗ وَمَنْ قَدِرَ  
عَلَيْهِ رِزْقُهُ فَلْيُنْفِقْ مِمَّا آتَاهُ اللَّهُ ۗ  
لَا يَكْلِفُ اللَّهُ نَفْسًا إِلَّا مَا آتَاهَا ۗ سَيَجْعَلُ  
اللَّهُ بَعْدَ عُسْرٍ يُسْرًا ۙ

وَكَأَيِّن مِّن قَرْيَةٍ عَتَتْ عَنْ أَمْرِ رَبِّهَا  
وَرُسُلِهِ فَحَاسَبْنَاهَا حِسَابًا شَدِيدًا ۗ  
وَعَذَّبْنَاهَا عَذَابًا ثُكْرًا ۙ

فَذَاقَتْ وَبَالَ أَمْرِهَا وَكَانَ عَاقِبَةُ أَمْرِهَا  
خُسْرًا ۖ

أَعَدَّ اللَّهُ لَهُمْ عَذَابًا شَدِيدًا ۗ فَاتَّقُوا اللَّهَ  
يَا أُولِي الْأَلْبَابِ ۗ الَّذِينَ آمَنُوا ۗ قَدْ أَنْزَلَ  
اللَّهُ إِلَيْكُمْ ذِكْرًا ۙ

رَسُولًا يَتْلُو عَلَيْكُمْ آيَاتِ اللَّهِ مُبَيِّنَاتٍ

4. Në ajetet 11 dhe 12, Zoti i Madhërishtëm përdori fjalën zbritje (*nuzul*) për Profetin Muhammed<sup>savs</sup>, por të gjithë e dimë faktin se Pejgamberi<sup>savs</sup> nuk zbriti prej qiellit. Zbritja në këtë kontekst nënkupton dhuratën më të mirë të Zotit për njerëzimin. Pra, duke thënë se Allahu e ka zbritur Profetin Muhammed<sup>savs</sup> si udhërrëfyes dhe të dërguar, Ai ka vulosur epërsinë e tij mbi të gjithë të Dërguarit e tjerë. Po në këtë kuptim, Profeti Muhammed<sup>savs</sup> bëri profecinë duke thënë se do të zbresë *Hazret* Isai, Biri i Merjemes, por fatkeqësisht disa njerëz



ajetet e qarta të Allahut, që t'i nxjerrë ata që besuan dhe bënë të mira nga errësirat në dritë. Ai që beson në Allah dhe bën të mira, (Allahu) do ta çojë atë në xhenete, nëpër të cilat rrjedhin lumenj; (të tillët) në to do të jetojnë përgjithmonë. Pa dyshim, Allahu u ka përgatitur shumë të mirë ushqimin.

13. Allahu është Ai që krijoi shtatë qiej dhe po aq (edhe) toka. Urdhri (i Tij) zbrit në to, që ju të dini që Allahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë, dhe se Allahu ka rrethuar çdo gjë me dije.<sup>5</sup>

يُخْرِج الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ  
مِنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ وَمَنْ يُؤْمِنُ بِاللَّهِ  
وَيَعْمَلْ صَالِحًا يُدْخِلْهُ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ  
تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا أَبَدًا قَدْ  
أَحْسَنَ اللَّهُ لَهُ رِزْقًا ﴿١٣﴾

اللَّهُ الَّذِي خَلَقَ سَبْعَ سَمَاوَاتٍ وَمِنَ  
الْأَرْضِ مِثْلَهُنَّ يَتَنَزَّلُ الْأَمْرُ بَيْنَهُنَّ  
لِتَعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ  
وَ أَنَّ اللَّهَ قَدْ أَحَاطَ بِكُلِّ شَيْءٍ عِلْمًا ﴿١٤﴾

e keqkuptuan profecinë dhe besojnë se *Hazret Isai*, Biri i Merjemes do të zbresë prej qiellit, fizikisht.

5. Një kuptim i “shtatë tokave” është që banorët e tokës janë ndarë në shtatë pjesë. Me fjalë të tjera, në shtatë kontinente. Ajo që duhet theksuar këtu është fakti që ndarja e tokës në shtatë toka, duket se është një ndarje e shpallur prej Zotit. Kuptimi i dytë është ai që thamë në parathënien e sures, që Kurani i Shenjtë hedh dritë edhe mbi jetën jashtëtokësore, duke pohuar se ka edhe toka të tjera përveç planetit të Tokës, dhe edhe atje zbrit urdhri i Zotit të Plotfuqishëm. Lexoni edhe 42:30.

## Surja 66 – Et-Tahrim

Surja Et-Tahrim është medinase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka trembëdhjetë ajete.

Surja e mëparshme shpalosi disa sekrete shumë të mëdha të universit, kurse kjo sure zbulon disa sekrete të vogla nga jeta e përditshme. Si të thuash, përmes shpalljes së Tij, Allahu i Madhërishëm i zbuloi Profetit Muhammed<sup>savs</sup> jo vetëm çështje të mëdha të botës së padukshme, por edhe ato të imëta të saj. Në këtë kuptim vihet në dukje cilësia e Kuranit që përmendet në një ajet: “Ç’është ky libër që nuk lëshon asnjë gjë të vogël e as të madhe, pa e numëruar!” (18:50).

Kjo sure përmend pendesën e sinqertë, pra, “*teubeten nasuha*”, dhe u tërheq vëmendjen shërbëtorëve të Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, që nëse do ta arrijnë pendesën e sinqertë, Allahu i Madhërishëm është i Plotfuqishëm t’ua falë të gjitha mëkatet, qofshin të vogla, qofshin të mëdha. Përmendet edhe shenja që do të tregojë nëse atyre u është pranuar pendesa apo jo. E ajo shenjë është që ata ditë për ditë do të ndiejnë aftësinë për t’u larguar nga mëkatet, derisa, me ndihmën e Allahut të Madhërishëm, do të largohen prej tyre tërësisht. Kjo fazë e largimit prej mëkateve në jetën e tyre do të fillojë për shkak të dritës që Allahu do t’ua dhurojë, dhe ata do të jetojnë porsia ai, i cili tek ecën gjatë natës, me ndihmën e ndriçimit, i dallon rreziqet dhe ruhet prej tyre. Andaj, fjalët “*drita e tyre do të vrapojë përpara tyre dhe në të djathtën e tyre*” tregojnë se Allahu i udhëzon ata. Fjalët “në të djathtën e tyre” duket se tregojnë që kjo dritë nuk u jepet të ligjve që quhen “njerëzit e së majtës”, por u jepet “njerëzve të së djathtës”, të cilët përballë çdo ligësie, përparësinë ia japin mirësisë. Pikërisht këta janë ata të cilëve u jepet kjo dritë, në mënyrë që ata të fitojnë qëndrueshmëri në rrugën e mirësisë.

Në pjesën e fundit të kësaj sureje, Allahu i Madhërishëm jep shembullin e mohuesve me dy gra fatlige, të cilat edhe pse ishin brenda familjes së Profetëve, praktikisht i tradhtuan përgjegjësitë e tyre. Dhe pas tyre, jep edhe shembullin e besimtarëve me dy gra shumë të pastra. Njëra prej tyre edhe pse ishte gruaja e një armiku mizor e gjakatar të Zotit të Madhërishëm, prapëseprapë, arriti ta mbronte besimin e vet. Ndërsa gruaja e dytë që Zoti përmend është *Hazret Merjemja*<sup>as</sup>, së cilës i dhuroi *Hazret Mesihun*<sup>as</sup> përmes mrekullisë së Tij, fëmijë i cili erdhi në jetë jo për shkak të dëshirave personale të *Hazret Merjemes*. Për sa kohë që ky shembull është për besimtarët muslimanë, pra për shërbëtorët e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, ajeti i fundit i kësaj sureje tregon që ndonjë musliman i pastër dhe i sinqertë, i cili nuk do të kishte etje për grada të larta, por do të ishte krejtësisht i përlurur, do ta arrinte gradën e *Hazret Merjemes*, dhe pikërisht atij, Allahu i Madhërishëm do t’i frynte Shpirtin prej Vetes, rrjedhimisht, ai do të bëhej shëmbëlltyrë e *Hazret Isait* birit të *Merjemes*<sup>as</sup>. Kjo është arsyeja që në këtë ajet, për atë të cilit Allahu do t’i frynte Shpirtin, Allahu i Madhërishëm ka përdorur përemrin e gjinisë mashkullore: “Ne i frymë *atij*” (arab. *fenefahna fihî*), sepse i referohet burrit besimtar që do ta plotësonte shembullin e paraqitur.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithë-mëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. O Profet! Pse e bën të ndaluar atë që Allahu të ka lejuar ty? Kërkon pëlqimet e grave të tua. Dhe Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.<sup>1</sup>

يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ لِمَ تُحَرِّمُ مَا أَحَلَّ اللَّهُ لَكَ ۚ  
تَبَغَىٰ مَرْصَاتٍ أَرْوَاكِ ۗ وَاللَّهُ عَفُورٌ  
رَّحِيمٌ ①

3. Allahu ju ka obliguar t'i zgjidhni betimet tuaja (të cilat nuk janë të denja).<sup>2</sup> Allahu është Miku juaj dhe Ai është i Gjithëdijshmi, i Urti.

قَدْ فَرَضَ اللَّهُ لَكُمْ تَحْلَةَ أَيْمَانِكُمْ ۚ  
وَاللَّهُ مُؤَلِّمُكُمْ ۚ وَهُوَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ ①

4. Dhe kur Profeti i kumtoi një lajm të fshehtë njëres prej grave të tij, dhe ajo e shfaqti atë; Allahu ia zbuloi (Profetit, dhe Profeti) i tregoi (gruas) një pjesë dhe një pjesë tjetër toleroi. Pra, kur ai ia tregoi asaj (ngjarjen), ajo e pyeti: “Kush ta ka treguar këtë?” (Profeti) tha: “Ma tregoi i Gjithëdijshmi, i Gjithinformuari.”

وَإِذْ أَسْرَأَ النَّبِيُّ إِلَىٰ بَعْضِ أَرْوَاحِهِ حَدِيثًا ۚ  
فَلَمَّا بَيَّنَّاتُ بِهِ وَأَظْهَرَهُ اللَّهُ عَلَيْهِ عَرَفَ  
بَعْضَهُ ۚ وَأَعْرَضَ عَنْ بَعْضٍ ۚ فَلَمَّا بَيَّنَّاتُ  
بِهِ قَالَتْ مَنْ أَبْأَكَ هَذَا ۗ قَالَ نَبَاتِي  
الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ ①

1. Nuk është e nevojshme të hyjmë në çështjen se çfarë ishte ajo që nuk u pëlqente grave të Profetit<sup>savs</sup>, të cilën Profeti<sup>savs</sup> për hir të tyre, e quajti të ndaluar për veten e tij. Çfarëdo që të ishte ajo, Allahu e kishte quajtur të lejuar. Atëherë porosia në këtë ajet është që për gjërat që Allahu i Madhërishtëm i ka bërë të lejuara apo të ndaluar në mënyrë të qartë, robi nuk ka të drejtë t'ua ndryshojë statusin e tyre. Për njerëzit e thjeshtë edhe mund të jetë e lejuar që ata të mos përdorin në mënyrë të përhershme diçka të caktuar në bazë të pëlqimeve apo të mospëlqimeve personale, pasi sjellja e tyre nuk përbën model, por për të Dërguarin e Allahut<sup>savs</sup> kjo ishte shumë e rëndësishme, pasi ai është shembulli i përkryer për tërë *umetin* e tij.

2. Ajeti nuk u referohet betimeve të sinqerta e të lejuara, por vetëm atyre betimeve që bëhen për të ndryshuar diçka të lejuar në të ndaluarën dhe anasjelltas. Allahu porositi që betimet e tilla të mos i plotësoni, megjithatë, edhe për to, duhet të jepni shpagimin që jepet në rast të thyerjes së betimit.

5. Nëse ju të dyja pendoheni tek Allahu, (është mirë për ju, sepse) zemrat tuaja ishin anuar (nga gabimi); dhe nëse bashkëpunoni kundër tij (pra, kundër Profetit), atëherë Allahu është Miku i tij, dhe po kështu edhe Xhibraili dhe çdo i sinqertë nga besimtarët. Gjithashtu edhe engjëjt janë ndihmës të tij.<sup>3</sup>

6. Ka mundësi që nëse (Profeti) ju divorcon, Zoti i tij t'ju zëvendësojë me gra më të mira se ju, (që do të jenë) muslimane, besimtare, të bindura, pendesëbërëse, adhuruese, agjëruese, të veja ose të virgjëra.

7. O ju që besuat! Shpëtoni veten tuaj dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët; mbi të qëndrojnë engjëjt shumë të fortë (dhe) të rreptë (që) nuk e kundërshtojnë Allahun në urdhrat që u jep, dhe bëjnë vetëm atë për të cilën urdhërohen.

8. O ju që mohuat! Mos u justifikoni sot! Në të vërtetë, ju do të shpërbleheni vetëm për atë që keni bërë.

إِنْ تَوْبَا إِلَى اللَّهِ فَقَدْ صَغَتْ قُلُوبُكُمَا  
وَأَنْ تَطَهَّرَا عَلَيْهِ فَإِنَّ اللَّهَ هُوَ مَوْلَاهُ  
وَ جِبْرِيْلُ وَصَالِحُ الْمُؤْمِنِينَ وَالْمَلَائِكَةُ  
بَعْدَ ذَلِكَ ظَهِيرٌ ۝

عَسَى رَبَّةٌ إِنْ طَلَّقَنَّ أَنْ يُبْدِلَهُ  
أَزْوَاجًا خَيْرًا مِنْكَ مُسْلِمَاتٍ مُؤْمِنَاتٍ  
فَقُنْتِ لِيَّ بِنَاتٍ عِيدَاتٍ سَخِيحَاتٍ ثَبَاتٍ  
وَ أَبْكَارًا ۝

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا قُوا أَنْفُسَكُمْ وَأَهْلِيكُمْ  
نَارًا وَقُودُهَا النَّاسُ وَالْحِجَارَةُ عَلَيْهَا  
مَلَائِكَةٌ غِلَاظٌ شِدَادٌ لَا يَعْصُونَ اللَّهَ مَا  
أَمَرَهُمْ وَيَفْعَلُونَ مَا يُؤْمَرُونَ ۝

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ كَفَرُوا لَا تَعْتَذِرُوا الْيَوْمَ  
إِنَّمَا تُجْرُونَ مَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ ۝

3. Allahu i Madhërishëm në këtë ajet flet për dy nga bashkëshortet e Profetit<sup>savs</sup>, por pa ua përmendur emrat. Njëri prej tyre Profeti<sup>savs</sup> i kishte treguar diçka sekrete që ajo të mos i tregonte tjetërkujt. Për sa kohë që Allahu i Madhërishëm e mbuloi veprimin e kësaj ngjarjeje, nuk i takon robit të hamendësojë për të zbuluar se çfarë kishte ndodhur.

9. O ju që besuat! Përkuluni tek Allahu duke bërë pendesë të sinqertë. Ka mundësi që Zoti juaj t'jua largojë mëkatet dhe t'ju çojë në xhenete nëpër të cilat rrjedhin lumenj; ditën kur Allahu nuk do ta poshtërojë Profetin, si dhe ata që besuan bashkë me të; drita e tyre do të vrapojë përpara tyre dhe në të djathtën e tyre. Ata do të thonë: “O Zoti ynë! Na plotëso dritën tonë dhe na fal. Pa dyshim, Ti je i Plotfuqishëm për çdo gjë.”

10. O Profet! Lufto me mohuesit dhe (me) hipokritët dhe ji i ashpër kundër tyre. Streha e tyre është xhehenemi. Sa destinacion i keq është ai!

11. Për ata që mohuan, Allahu jep shembullin e gruas së Nuhut dhe të gruas së Lutit. Ato ishin nën dy robër prej robërve Tanë të delirë, por tradhtuan. Atëherë ata nuk i shpëtuan dot prej Allahut aspak; dhe (për to) u tha: “Hyni në zjarr bashkë me ata që hyjnë!”

12. Dhe për ata që besuan, Allahu jep shembullin e gruas së Faraonit. Kur ajo tha: “O Zoti im! Ndërtomë një shtëpi pranë Teje në xhenet, më shpëto nga Faraoni dhe nga vepra e tij, dhe më shpëto nga populli keqbërës!”

13. Dhe (shembullin e) Merjemes, vajzës së Imranit, e cila ruajtji nderin

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا تَوْبُوا إِلَى اللَّهِ تَوْبَةً  
تَصَوِّحًا ۗ عَسَىٰ رَبُّكُمْ أَنْ يُكَفِّرَ عَنْكُمْ  
سَيِّئَاتِكُمْ وَيُدْخِلَكُمْ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ  
تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ ۗ يَوْمَ لَا يُخْزِي اللَّهُ النَّبِيَّ  
وَالَّذِينَ آمَنُوا مَعَهُ ۗ نُورُهُمْ يَسْعَىٰ بَيْنَ  
أَيْدِيهِمْ وَبِأَيْمَانِهِمْ يَقُولُونَ رَبَّنَا آتِنَا  
مِمَّا نُنُورِنَا وَاعْفِرْنَا ۗ إِنَّكَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ  
قَدِيرٌ ﴿٩﴾

يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ جَاهِدِ الْكُفَّارَ وَالْمُنَافِقِينَ  
وَاعْلَمْ عَلَيْهِمْ ۗ وَمَأْوَهُمْ جَهَنَّمُ  
وَبِئْسَ الْمَصِيرُ ﴿١٠﴾

ضَرَبَ اللَّهُ مَثَلًا لِلَّذِينَ كَفَرُوا امْرَأَتَ  
نُوحَ وَامْرَأَتَ لُوطَ ۗ كَانَتَا تَحْتَ عَبْدَيْنِ  
مِنْ عِبَادِنَا صَالِحَيْنِ فَخَانَتَهُمَا فَلَمْ يُعْنِنَا  
عَهُمَا مِنَ اللَّهِ شَيْئًا ۗ وَقِيلَ ادْخُلَا النَّارَ  
مَعَ الدَّٰخِلِينَ ﴿١١﴾

وَضَرَبَ اللَّهُ مَثَلًا لِلَّذِينَ آمَنُوا امْرَأَتَ  
فِرْعَوْنَ ۗ إِذْ قَالَتْ رَبِّ ابْنِ لِي عِنْدَكَ بَيْتًا  
فِي الْجَنَّةِ وَنَجِّنِي مِنْ فِرْعَوْنَ وَعَمَلِهِ  
وَنَجِّنِي مِنَ الْقَوْمِ الظَّالِمِينَ ﴿١٢﴾

وَمَرْيَمَ ابْنَتَ عِمْرَانَ الَّتِي أَحْصَنَتْ

e vet, atëherë Ne i frymë atij (fëmije) prej Shpirtit Tonë, dhe ajo vërtetoi fjalët e Zotit të vet dhe Librat e Tij, dhe ajo ishte ndër të bindurit.<sup>4</sup>

فَرَجَهَا فَفَنَحْنَا فِيهِ مِنْ رُوحِنَا وَصَدَّقَتْ  
بِكَلِمَاتِ رَبِّهَا وَكُتُبِهِ وَكَانَتْ مِنَ الْقَاتِلِينَ ﴿١٧﴾

4. Ajetet 12-13: Kurani i Shenjtë tregoi ngjashmërinë e besimtarëve me dy gra të ndryshme. Pra, dha dy shembuj për ta. Shembulli i parë është i gruas së Faraonit, e cila i kërkon mbrojtje Zotit nga një burrë i keq siç e kishte ajo. Ky shembull është i atyre besimtarëve të cilët dorëzohen herë pas here përpara tundimeve të tyre, gabojnë dhe më pas edhe pendohen. Nefsi i tyre i shqetëson porsia Faraoni që e shqetësonte gruan e tij. Këta kanë *shpirtin qortues* (arab. *nefs levvameh*), andaj, gjithmonë përpiqen për t'u ruajtur nga ligësia, pavarësisht nga fuqia e tyre e dobët. Shembulli i dytë është i atyre besimtarëve, të cilët jo vetëm që e kanë shpëtuar veten nga ligësitë, madje i përngajnë *Hazret Merjemes* në pastërtinë shpirtërore. Çdo besimtar që përsos dëlirësinë dhe druajtjen e tij ndaj Zotit, ngjason me Merjemen, dhe Zoti fryn Shpirtin e Tij në të, dhe pikërisht ai më pas bëhet edhe i biri i Merjemes. Në një hadith thuhet se asnjë fëmijë nuk lind pa prekjën e djallit, përveç Merjemes dhe birit të Merjemes (Buhari, nr. 4548). Nëse ky hadith merret fjalë për fjalë, *ma'adhallah*, del që të gjithë Profetët e nderuar të jenë prekur nga djalli. Edhe kuptimi i këtij hadithi është ai që thuhet në këtë ajet, që çdo besimtar që përsoset në maksimum, Allahu fryn Shpirtin e Tij në të, dhe ai bëhet biri i Merjemes. Kjo është arsyeja që pas përmendjes së Merjemes, në këtë ajet Zoti përdori përemrin e gjinisë mashkullore duke thënë "Ne i frymë atij prej Shpirtit Tonë" [kurse në një ajet tjetër të ngjashëm, ku nuk ishte kjo temë, ka përdorur përemrin e gjinisë femërore (21:92)].

Ky ajet përbën edhe profeci që në *umetin* e Muhammedit<sup>SAVS</sup> do të ishte ndonjë që do ta plotësonte shembullin e *Hazret Merjemes* dhe, pas bekimit të Zotit, ai do të bëhej edhe i biri i Merjemes. Dhe kjo nuk është për t'u çuditur. Muslimanët u vendosin fëmijëve emrat Muhammed, Isa, Musa, Jakub, Ismail, Ibrahim etj.. Pse duhet të çuditësh nëse Zoti mund të quajë dikë Isai biri i Merjemes! Ata që çuditen nga kjo profeci, duke qenë edhe muslimanë, janë të kënaqur të marrin pjesë në profecinë që flet për të keqen duke thënë se muslimanët do t'u përngajnë judenjve (hebrenjve), pra, popullit të *Hazret Musait* në ligësi e mëkate, por nuk dëshirojnë të marrin pjesë në profecinë që flet për të mirën, që thotë se prej tyre do të dalë edhe Mesihu biri i Merjemes.

## Surja 67 – El-Mulk

Surja El-Mulk është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka tridhjetë e një ajete.

Surja fillon me ajetin “Zotëruesi i bekimeve është Ai në dorën e të cilit është Sundimi...”. Pra, Ai është Sundimtari dhe bën çfarë të dojë. Kjo ndoshta mund të lidhet edhe me temën e çuditshme që u përmend në fund të sures paraardhëse. Pas këtij ajeti, Zoti i Madhërishëm flet për krijimin e jetës përmes vdekjes, si të thuash, njofton që ashtu siç Ai është i Plotfuqishëm të krijojë jetë nga të vdekurit truporë, në të njëjtën mënyrë, Ai ka fuqi të plotë të ringjallë edhe të vdekurit shpirtërorë. Ky është një lajm i mirë për *umetin* e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>.

Menjëherë pas kësaj, Zoti tha: Studioni gjithë universin, ju nuk do të gjeni asnjë të metë në të, dhe ai do të dëshmojë vetëm për Një Krijues. Nëse rastësia do të ishte krijuesja e kësaj gjithësie, do të gjenit patjetër ndonjë të metë, madje do të shikonit vetëm çorganizim. Po kështu, nëse edhe zota të tjerë do të ishin bashkëpunëtorë me Krijuesin në krijimin e universit, përsëri, do të gjenit përplasje të shumta në ligjet e secilit bashkëpunëtor. Kështu që, kjo sure e sfidon gjithë njerëzimin t’u hedhin një sy të vëmendshëm sekreteve të universit, por ata nuk do të arrijnë të gjejnë qoftë një të metë të vetme, madje shikimi i tyre do të kthehet i lodhur dhe i dështuar.

Kjo sure flet për disa shpendë shpirtërorë, të cilët gëzojnë fluturimin e lartë në hapësirën e gjerë të qiellit. Allahu i Madhërishëm ashtu siç u ka dhënë fuqinë shpendëve të tokës aftësinë e fluturimit dhe i vuri në shërbim në atmosferën e tokës, mes qiellit e dheut, në të njëjtën mënyrë, Ai ua jep këtë aftësi në aspektin shpirtëror edhe robërve të Tij besimtarë. Karshi tyre, nuk u jepet asnjë lartësim shpirtëror gjallesave që ecin me fytyrë në tokë, as në kuptimin fizik, as në atë shpirtëror.

Ajeti i fundit i kësaj sureje thotë: Ju përfitoni çdo çast nga uji jetëdhënës që zbret prej qiellit, por a keni menduar ndonjëherë që nëse ai futet në thellësitë e tokës për shkak të thatësirave të vazhdueshme, nga do ta gjeni sërish ujin e pastër?! Kështu që, sikundër edhe ujin lëndor, edhe ujin shpirtëror, njeriu e gëzon vetëm me bekimin e veçantë të Zotit të Madhërishëm.

Ajetet:  
31٦٧ سُورَةُ الْمُلْكِ  
67. EL-MULK  
MekaseRukutë:  
2

1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ۝

2. Zotëruesi i bekimeve është Ai, në dorën e të cilit është Sundimi, dhe Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë.

تَبَارَكَ الَّذِي بِيَدِهِ الْمُلْكُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ۝

3. (Ai) që krijoi vdekjen dhe jetën, që t'ju sprovonë se cili prej jush është më i miri në vepra. Ai është Mbizotëruesi, Falësi.

الَّذِي خَلَقَ الْمَوْتَ وَالْحَيَاةَ لِيَبْلُوَكُمْ أَيُّكُمْ أَحْسَنُ عَمَلًا وَهُوَ الْعَزِيزُ الْعَفُورُ ۝

4. (Ai) që krijoi shtatë qiej në shtresa. Ti nuk sheh asnjë mospërputhje në krijimin e të Gjithëmëshirshmit. Andaj, hidh shikimin, a sheh dot ndonjë të metë?

الَّذِي خَلَقَ سَبْعَ سَمَاوَاتٍ طِبَاقًا مَا تَرَى فِي خَلْقِ الرَّحْمَنِ مِنْ تَفْوُتٍ فَارْجِعِ الْبَصَرَ هَلْ تَرَى مِنْ فُطُورٍ ۝

5. Përsëri hidhe shikimin! Shikimi (yt) te ti do të kthehet, i dështuar dhe i lodhur.<sup>1</sup>

ثُمَّ ارْجِعِ الْبَصَرَ كَرَّتَيْنِ يَنْقَلِبْ إِلَيْكَ الْبَصَرُ خَاسِئًا وَهُوَ حَسِيرٌ ۝

6. Sigurisht, Ne zbukurruam qiellin e afërt me ndriçime, të cilat i bëmë mjet për zënije kundër djajve, dhe për ta kemi përgatitur ndëshkimin e zjarrit.

وَلَقَدْ زَيَّنَّا السَّمَاءَ الدُّنْيَا بِمَصَابِيحٍ وَجَعَلْنَاهَا رُجُومًا لِلشَّيَاطِينِ وَأَعْتَدْنَا لَهُمْ عَذَابَ السَّعِيرِ ۝

7. Dhe për ata që mohuan Zotin e tyre, ka ndëshkim të xhehenemit. Sa destinacion i keq është ai!

وَالَّذِينَ كَفَرُوا بِرَبِّهِمْ عَذَابَ جَهَنَّمَ وَسَاءَ الْمَصِيرُ ۝

8. Kur do të hidhen në të, do të

إِذَا أُلْقُوا فِيهَا سَمِعُوا لَهَا شَهيقًا وَ هِيَ

1. Këto ajete e sfidojnë njeriun që të studiojë universin sa të mundet, por ai nuk do të gjejë dot asnjë të metë në univers, pasi universi është krijimtari e Një Krijuesi të Vetëm dhe të Plotfuqishëm.



dëgjojnë një klithmë, ndërkohë ai do të valojë.

تَفُورٌ ۝

9. (Xhehenemi) gati të shpërthejë nga zemërata. Kurdoherë që do të hidhet një grup në të, rojet e tij do t'i pyesin: “A nuk ju kishte ardhur ndonjë alarmues?”

تَكَادُ تَمَيَّرُ مِنَ الْغَيْظِ ۗ كُلَّمَا أُلْقِيَ فِيهَا فَوْجٌ سَأَلَهُمْ خَزَنَتُهَا أَلَمْ يَأْتِكُمْ نَذِيرٌ ۝

10. Ata do të thonë: “Patjetër që po! Neve na erdhi alarmues, por ne (e) quajtëm gënjeshtar dhe thamë – Allahu nuk zbriti asnjë gjë, ju jeni në devijim të madh.”<sup>2</sup>

قَالُوا بَلَىٰ قَدِ جَاءَنَا نَذِيرٌ ۗ فَكَذَّبْنَا وَقُلْنَا مَا نَزَّلَ اللَّهُ مِنْ شَيْءٍ ۗ إِنْ أَنْتُمْ إِلَّا فِي ضَلَالٍ كَبِيرٍ ۝

11. Dhe do të thonë: “Po të kishim dëgjuar ose të kishim logjikuar, nuk do të ishim mes banorëve të zjarrit.”<sup>3</sup>

وَقَالُوا لَوْ كُنَّا نَسْمَعُ أَوْ نَعْقِلُ مَا كُنَّا فِي أَصْحَابِ السَّعِيرِ ۝

12. Pra, ata e pranuan mëkatin e tyre. Atëherë, u shkatërrofshin banorët e zjarrit!

فَاعْتَرَفُوا بِذَنبِهِمْ ۗ فَسَحَقْنَا لِأَصْحَابِ السَّعِيرِ ۝

13. Pa dyshim, ata që i frikësohen Zotit të tyre kur janë vetëm, do të kenë falje dhe shpërblim shumë të madh.

إِنَّ الَّذِينَ يَخْشَوْنَ رَبَّهُم بِالْغَيْبِ لَهُمْ مَغْفِرَةٌ وَأَجْرٌ كَبِيرٌ ۝

14. Në daç fshihni fjalën tuaj, apo e zbuloni atë, (ta dini se) Ai është i Gjithëdijshëm për çdo gjë që mbajnë kraharorët.

وَأَسْرُوا قَوْلَكُمْ أَوِ اجْهَرُوا بِهِ ۗ إِنَّهُ عَلِيمٌ بِذَاتِ الصُّدُورِ ۝

2. Këto ajete tregojnë se njerëzit do të shkojnë në xhehenem sepse nuk do të kenë pranuar Profetin e kohës së tyre. Kjo është arsyeja që edhe i Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> tha: “Ai që vdes pa e njohur Imamin, ka pësuar vdekje të injorancës.” (Musned Ahmed, nr. 16876).

3. Banorët e xhehenemit do të thonë: Po të kishim punuar me mend dhe të kishim logjikuar fenë dhe besimin siç duhet, ose po të kishim dëgjuar dhe ndjekur me vëmendje fjalët dhe shkrimet e të mençurve dhe të studiuesve, sot nuk do të ishim në ferr. Kjo tregon se pa e përdorur logjikën dhe pa u thelluar, besimi nuk saktësohet. Dija e vërtetë dhe logjika e shëndoshë janë shenjat e fatmirësisë, kurse fatligu nuk i përdor këto dhe të mirin e quan të lig, të ligun të mirë.

15. A nuk ditka Ai që krijoi?! E po Ai është i Mprehti, i Gjithinformuari.

أَلَا يَعْلَمُ مَنْ خَلَقَ ۖ وَهُوَ اللَّطِيفُ  
الْخَبِيرُ ﴿١٥﴾

16. Është Ai që bëri tokën të nënshtruar për ju, andaj, ecni në rrugët e saj dhe hani nga mirësitë e Tij. Tek Ai do të ringjalleni.

هُوَ الَّذِي جَعَلَ لَكُمُ الْأَرْضَ ذُلُولًا فَامْسُوا  
فِي مَنَازِلِهَا وَكُلُوا مِنْ رِزْقِهِ ۗ وَإِلَيْهِ  
الذُّشُورُ ﴿١٦﴾

17. A jeni të sigurt se Ai që është në qiell nuk do t'ju fundosë në tokë, (kur) ajo papritmas do të dridhet?!

ءَأَمِنْتُمْ مَّن فِي السَّمَاءِ أَنْ يَخْسِفَ بِكُمُ  
الْأَرْضَ فَإِذَا هِيَ تَمُورٌ ﴿١٧﴾

18. Apo jeni të sigurt se Ai që është në qiell nuk do t'ju lëshojë një uragan rëre?! Atëherë do të mësoni se si është alarmimi Im!

أَمْ أَمِنْتُمْ مَّن فِي السَّمَاءِ أَنْ يُرْسِلَ عَلَيْكُمْ  
حَاصِبًا ۗ فَسَتَعْلَمُونَ كَيْفَ نَذِيرٌ ﴿١٨﴾

19. Sigurisht, edhe ata që ishin para tyre kanë quajtur gënjeshtër (të vërtetën). Atëherë si qe ndëshkimi Im?!

وَلَقَدْ كَذَّبَ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ فَكَيْفَ كَانَ  
نَكِيرٌ ﴿١٩﴾

20. A nuk i kanë parë shpendët sipër tyre, (që) hapin e mbledhin krahët?! Asgjë nuk i mban ata përveç të Gjithëmëshirshmit. Ai është Gjithëshikuesi i çdo gjëje.

أَوَلَمْ يَرَوْا إِلَى الطَّيْرِ فَوْقَهُمْ صَفْتٍ وَ  
يَقْبِضْنَ ۗ مَا يَمْسُكُهُنَّ إِلَّا الرَّحْمَنُ ۗ إِنَّهُ  
بِكُلِّ شَيْءٍ بَصِيرٌ ﴿٢٠﴾

21. “Kush janë këta që mund të bëhen ushtri për ju e t’ju ndihmojnë përballë të Gjithëmëshirshmit?!” Njëmend, mohuesit janë vetëm në një mashtrim.

أَمْ مِنْ هَذَا الَّذِينَ هُوَ جُنْدٌ لَكُمْ يَصْرُوكُمْ  
مَنْ دُونِ الرَّحْمَنِ ۗ إِنَّ الْكٰفِرُونَ إِلَّا فِي  
عُرُورٍ ﴿٢١﴾

22. “Kush është ai që mund t’ju ushqejë, nëse Ai e ndal furnizimin e Tij?!” Por ata po zhyten në rebelim dhe urrejtje.

أَمْ مِنْ هَذَا الَّذِينَ يَرِزُّكُمْ ۗ إِنَّ أَمْسَكَ  
رِزْقَهُ ۗ بَلْ لَّجُوا فِي عُتُوٍّ وَنُفُورٍ ﴿٢٢﴾

23. Atëherë, a është në udhë të mbarë

أَفَمَنْ يَمْشِي مُكِبًّا عَلَى وَجْهِهِ أَهْدَىٰ

ai që ecën i përmbysur apo ai që ecën me saktësi në rrugën e drejtë?!

24. Thuaj: “Është Ai që ju krijoi dhe ju dhuroi dëgjimin, shikimin dhe zemrën. Sa pak e falënderoni.”

25. Thuaj: “Është Ai që ju përhapi në tokë dhe tek Ai do të mblidheni.”

26. Ata pyesin: “Kur (do të përmbushet) ky premtim, nëse jeni të vërtetë?”

27. Thuaj: “Dija është vetëm tek Allahu, kurse unë jam vetëm një alarmues i qartë.”

28. E kur ata do ta shohin të afruar, mohuesve do t’u prishen fytyrat, dhe do t’u thuhet: “Kjo është ajo që e kërkonit!”

29. Thuaj: “Nëse Allahu më shkatërron mua dhe atë që është me mua, ose na mëshiron, më thoni se kush do t’i strehojë mohuesit nga ndëshkimi i dhimbshëm?!”

30. Thuaj: “Ai është i Gjithëmëshirshmi, të cilin e besuam dhe po tek Ai u mbështetëm. Andaj, ju së shpejti do të mësoni se kush ka rënë në devijim të qartë.”

31. Thuaj: “Nëse uji juaj do të përfundojë thellë (në tokë), kush do t’ju sjellë (sërish) ujë burimi?!”

أَمْ مَنْ يَمْشِي سَوِيًّا عَلَىٰ صِرَاطٍ مُّسْتَقِيمٍ ﴿٢٧﴾

قُلْ هُوَ الَّذِي أَنْشَأَكُمْ وَجَعَلَ لَكُمُ السَّمْعَ  
وَالْأَبْصَارَ وَالْأَفْئِدَةَ ۗ قَلِيلًا مَّا تَشْكُرُونَ ﴿٢٨﴾

قُلْ هُوَ الَّذِي ذَرَأَكُمْ فِي الْأَرْضِ وَإِلَيْهِ  
تُحْشَرُونَ ﴿٢٩﴾

وَيَقُولُونَ مَتَىٰ هَذَا الْوَعْدُ إِنْ كُنْتُمْ  
صَادِقِينَ ﴿٣٠﴾

قُلْ إِنَّمَا الْعِلْمُ عِنْدَ اللَّهِ ۗ وَإِنَّمَا أَنَا نَذِيرٌ  
مُّبِينٌ ﴿٣١﴾

فَلَمَّا رَأَوْهُ زُلْفَةً سَيِّتَتْ وُجُوهُ الَّذِينَ  
كَفَرُوا وَقِيلَ هَذَا الَّذِي كُنْتُمْ بِهِ  
تَدَّعُونَ ﴿٣٢﴾

قُلْ أَرَأَيْتُمْ إِنْ أَهْلَكَنِيَ اللَّهُ وَمَنْ مَعِيَ  
أَوْ رَحِمَنَا ۗ فَمَنْ يُجِيرُ الْكَافِرِينَ مِنْ  
عَذَابِ أَلِيمٍ ﴿٣٣﴾

قُلْ هُوَ الرَّحْمَنُ أَمَّا بِهِ وَعَلَيْهِ تَوَكَّلْنَا  
فَسَتَعْلَمُونَ مَنْ هُوَ فِي ضَلَالٍ مُّبِينٍ ﴿٣٤﴾

قُلْ أَرَأَيْتُمْ إِنْ أَصْبَحَ مَاؤُكُمْ غَوْرًا  
ۗ فَمَنْ يَأْتِيكُمْ بِمَاءٍ مَّعِينٍ ۗ ﴿٣٥﴾

## Surja 68 – El-Kalem

Surja El-Kalem është zbritur në periudhën e hershme mekase dhe, bashkë me *bismillahin*, ka pesëdhjetë e tri ajete.

Kjo është surja e fundit që fillon me shkurtesa, konkretisht me shkurtësën *nun* ò (me shkronjën *n* të arabishtes) duke thënë: *Nun. Ò Beto hem për penën dhe për atë që (ato) shkruajnë!*

Një kuptim i kësaj shkronjeje është bojë shkrimi, pasi ata që shkruajnë me penën, gjithmonë janë nevojtarë të saj. Epoka e të gjitha përparimeve të njeriut, fillon me sundimin e penës.

Kuptimi tjetër i shkronjës *nun* në këtë sure mund të jetë ai Profet i Zotit, i cili në Kuranin e Shenjtë është quajtur “*Dhun-Nun*” (Njeriu i nun-it), pra, *Hazret Junusi*<sup>as</sup> (21:88). Kjo sepse Zoti e përmend edhe *Hazret Junusin*<sup>as</sup> në këtë sure duke iu referuar ngjarjes se ai ishte larguar i mërziur nga populli i tij, pasi pa që paralajmërimi që ai ua kishte dhënë për ndëshkim, sipas tij, nuk ishte plotësuar dhe se ai nuk kishte më fytyrë të përballej me ta. Atëherë Zoti i Madhërishëm i dha një mësim *Hazret Junusit*<sup>as</sup> duke shpjeguar se paralajmërimet e Zotit për ndëshkime edhe mund të evitohen, në rast se njerëzit që paralajmërohen, pendohen dhe i kërkojnë falje Zotit. Zoti i Madhërishëm e shpëtoi popullin e Junusit, por edhe vetë *Hazret Junusin*<sup>as</sup> dhe atij ia mësoi lutjen:

*“Nuk ka të adhurueshëm tjetër përveç Teje! Ti je i Shenjtë, unë isha i padrejtë!”* (21:88).

Është interesante që shkronja “*nun*” në këtë sure përsëritet shpesh, gjë që gjithashtu përkon me temat e saj. Pra, në asnjë ajet nuk shikon dot ndonjë disbalancë mes shkronjës grafike të *nun*-it dhe temave që parashtrihen në këtë sure.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ۞

2. *Nun.* Beto hem për penën dhe për atë që (ato) shkruajnë!

ن وَالْقَلَمِ وَمَا يَسْطُرُونَ ۞

3. Ti me bekimin e Zotit tënd, nuk je i çmendur.

مَا أَنْتَ بِمَجْنُونٍ ۞

4. Dhe për ty, pa dyshim, ka një shpërblim pambarim.

وَإِنَّ لَكَ لَأَجْرًا غَيْرَ مَمْنُونٍ ۞

5. Sigurisht, ti qëndron mbi morale madhore.<sup>1</sup>

وَإِنَّكَ لَعَلَىٰ خُلُقٍ عَظِيمٍ ۞

1. Zoti i Madhërishtëm e ndau jetën e Profetit tonë *Hazret* Muhammed<sup>savs</sup>, në dy pjesë. Pjesa e parë është ajo e vështirësive, e vuajtjeve dhe e shqetësimeve dhe pjesa e dytë është ajo e fitores. Kjo, në mënyrë që, gjatë vështirësive, të shfaqen ato virtyte që mund të shfaqen vetëm në kohën e vështirësive, ndërsa gjatë ditëve të fitores dhe të sundimit, të shfaqen ato virtyte, që nuk mund të shfaqen pa pasur pushtet. Prandaj, të dyja llojet e virtyteve të *Hazret* Profetit Muhammed<sup>savs</sup> u shfaqën në mënyrën më të qartë në të dyja situatat. Nëse do ta studiojmë pjesën e vështirësive të jetës së tij, e cila shtrihet gjatë trembëdhjetë viteve të tij në Mekë, do të dalë shumë e qartë që i Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> tregoi ato virtyte, të cilat mund t'i tregonte vetëm një njeri i vërtetë dhe i përsosur gjatë vështirësive. Për shembull, i mbështetet vetëm Zotit, nuk vajton dhe nuk ankohet, nuk ngathtësohet në misionin e tij, nuk ka frikë nga askush e nga asgjë. Të gjitha këto i Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> i ka treguar me aq bukuri, saqë shumë nga jobesimtarët e pranuan duke parë pikërisht këto virtyte tek ai dhe dëshmuan që derisa dikush nuk ka besim të plotë në Zot, nuk mund të tregohet kaq i duruar dhe i patundur ndaj vështirësive kaq të mëdha. Pastaj, gjatë kohës së dytë, asaj të fitores, të sundimit dhe të begatisë, virtytet e larta si falja, bujaria, guximi, etj., i Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> i shfaqti në mënyrë aq të përsosur, saqë një mori jobesimtarësh e pranuan fenë Islame pikërisht duke parë këto virtyte tek ai. Ai u fali atyre që i shkaktuan vuajtje, u mundësoi paqe dhe strehë atyre që e kishin dëbuar nga qyteti i tij, i begatoi ata që ishin nevojtarë dhe i fali armiqtë e tij më të mëdhenj, edhe pse i kishte kapur dhe kishte fuqi t'i ndëshkonte. Duke parë pikërisht këto virtyte të tij, shumë nga ata dëshmuan se askush nuk mund të shfaqë morale të tilla, përveçse ai që me të vërtetë vjen prej Zotit. Kjo ishte arsyeja që mlefet e vjetra të armiqve të tij, u pastruan përnjëherë. Virtytin e tij më të lartë, të cilin ai e shfaqti në jetën e tij, Kurani i Shenjtë e tregon në këto fjalë: Thuaju atyre që adhurojnë im, sakrificë ime, jeta ime dhe vdekja ime janë në rrugën e Zotit, (6:163) pra janë për të shfaqur madhështinë e Tij dhe për t'u mundësuar rehati robërve të Tij, në mënyrë që ata të gëzojnë jetën nga vdekja ime.

6. Do të shohësh edhe ti, e do të shohin edhe ata

فَسَبِّصْ وَمِمَّا يُبْصِرُونَ ﴿٦﴾

7. se cili prej jush është i çmendur.

بِأَيِّكُمْ الْمَفْتُونُ ﴿٧﴾

8. Sigurisht, Zoti yt e di më së miri atë i cili devijoi nga rruga e Tij, dhe po Ai i di më së miri edhe të udhëzuarit.

إِنَّ رَبَّكَ هُوَ أَعْلَمُ بِمَنْ ضَلَّ عَنْ سَبِيلِهِ  
وَهُوَ أَعْلَمُ بِالْمُهْتَدِينَ ﴿٨﴾

9. Mos i ndiq mohuesit.

فَلَا تُطِعِ الْمُكَذِّبِينَ ﴿٩﴾

10. Ata duan që, nëse ti zbutesh, edhe ata të zbuten.

وَدُّوا لَوْ تُدْهِنُ فَيُدْهِنُونَ ﴿١٠﴾

11. Mos ndiq asnjë të poshtër, berrejshëm,

وَلَا تُطِعِ كُلَّ حَلَّافٍ مَهِينٍ ﴿١١﴾

12. përfolës, që sorollatet për të përgojuar;

هَمَّازٍ مَشَّاءٍ مَبِيمٍ ﴿١٢﴾

13. ndalues të së mirës, shkelës, mëkatar të madh,

مَنَّاعٍ لِلْخَيْرِ مُعْتَدٍ أَثِيمٍ ﴿١٣﴾

14. të egër, që është edhe kopil!

عُتْلٍ بَعْدَ ذَلِكَ زَنِيمٍ ﴿١٤﴾

15. (Ai mburret vetëm) sepse ka pasuri dhe fëmijë!

أَنْ كَانَ ذَا مَالٍ وَبَنِينَ ﴿١٥﴾

16. Kur i lexohen ajetet Tona, thotë: “Janë përrallat e të parëve!”

إِذَا تُلِيَتْ عَلَيْهِ آيَاتُنَا قَالَ أَسَاطِيرُ  
الْأَوَّلِينَ ﴿١٦﴾

17. Ne do t’ia damkosim turirin!

سَنَسِمُهُ عَلَى الْخُرطومِ ﴿١٧﴾

18. Pa dyshim, Ne i sprovuam ata, siç i kemi sprovuar njerëzit e kopshtit; kur ata ishin betuar se do ta vilnin patjetër që në mëngjes;

إِنَّا بَلَوْنَهُمْ كَمَا بَلَوْنَا أَصْحَابَ الْجَنَّةِ  
إِذْ أَقْسَمُوا لَيُبْرِئَنَّهَا مَصْحِينًا ﴿١٨﴾

19. dhe nuk kishin bërë asnjë përjashtim, (duke thënë “në dashtë Zoti”).<sup>2</sup>

وَلَا يَسْتَنْوْنَ ﴿١٩﴾

20. Atëherë një vorbull prej Zotit tënd u rrokullis mbi të, ndërkohë ata ishin në gjumë.

فَطَافَ عَلَيْهَا طَآئِفٌ مِّن رَّبِّكَ وَهُمْ نَآئِمُونَ ﴿٢٠﴾

21. Dhe (kopshti) ishte i prerë që në agim!

فَأَصْبَحَتْ كَالصَّرِيمِ ﴿٢١﴾

22. Në mëngjes ata thirrën njëri-tjetrin:

فَتَنَادَوْا مُصْحِحِينَ ﴿٢٢﴾

23. “Nxitohuni te arat tuaja, nëse do të korrni sot!”

أَنِ اغْدُوا عَلَى حَرْثِكُمْ إِنْ كُنْتُمْ صَٰرِمِينَ ﴿٢٣﴾

24. U nisën dhe po i pëshpëritnin njëri-tjetrit:

فَأَنطَلَقُوا وَهُمْ يَخَافَتُونَ ﴿٢٤﴾

25. “Sot nuk duhet të na dalë përpara ndonjë nevojtar!”

أَن لَّا يَدْخُلَهَا الْيَوْمَ عَلَيْكُمْ مِّسْكِينٌ ﴿٢٥﴾

26. Shkuan me plan që ta realizonin patjetër.

وَعَدُوا عَلَى حَرْدٍ قَدْرَيْنَ ﴿٢٦﴾

27. Por kur e panë atë, thanë: “Ne paskemi gabuar rrugën!”

فَلَمَّا رَأَوْهَا قَالُوا إِنَّا لَضَّالُّونَ ﴿٢٧﴾

28. Jo, përkundrazi! Kemi humbur çdo gjë!”

بَلْ نَحْنُ مَحْرُومُونَ ﴿٢٨﴾

29. Më i miri i tyre tha: “A nuk ju thosha pse nuk po (e) përkujtoni (Allahun)?!”

قَالَ أَوْسَطُهُمْ أَلَمْ أَقُلْ لَكُمْ لَوْ لَا تَسْبِحُونَ ﴿٢٩﴾

2. Në arabisht, folja *jestethnun*, do të thotë të falënderosh Allahun për mirësitë e Tij dhe të thuash “në dashtë Allahu!” (inshaAllah). Besimtari duhet të mbështetet tek Zoti në çdo vendim që merr dhe të kërkojë ndihmë përmes dijes dhe fuqisë së Zotit, atëherë ai vetvetiu thotë “inshaAllah”. Por, këtë frazë të bekuar, nuk duhet ta bëjë mburojë për të mos realizuar fjalën që i ka dhënë dikujt, siç bëjnë shumë njerëz në këtë kohë.

30. Ata thanë: “I Shenjtë është Zoti ynë! Pa dyshim, Ne kemi qenë të padrejtë!”

قَالُوا سُبْحَانَ رَبَّنَا إِنَّا كُنَّا ظَالِمِينَ ﴿٣٠﴾

31. Atëherë vazhduan duke qortuar njëri-tjetrin.

فَأَقْبَلَ بَعْضُهُمْ عَلَى بَعْضٍ يَتَلَوْمُونَ ﴿٣١﴾

32. Thanë: “Mjerë ne! Ne kemi qenë shkelës!”

قَالُوا يَوَيْلَنَا إِنَّا كُنَّا ظَالِمِينَ ﴿٣٢﴾

33. Ka mundësi që Zoti ynë të na e zëvendësojë me një më të mirë se kjo. Pa dyshim, ne nga Zoti ynë anojmë.”

عَسَىٰ رَبَّنَا أَن يُبَدِّلَنَا خَيْرًا مِنْهَا إِنَّا إِلَىٰ رَبِّنَا رَاغِبُونَ ﴿٣٣﴾

34. Kështu është ndëshkimi. Dhe ndëshkimi i *ahiretit* është më i madhi. Sikur ta dinë!

كَذَٰلِكَ الْعَذَابُ ۗ وَلَعَذَابُ الْآخِرَةِ أَكْبَرُ ۗ لَوْ كَانُوا يَعْلَمُونَ ﴿٣٤﴾

35. Sigurisht, për të druajturit pranë Zotit të tyre ka xhenete plot bekime.

إِنَّ لِلْمُتَّقِينَ عِنْدَ رَبِّهِمْ جَنَّتِ التَّحِيمِ ﴿٣٥﴾

36. A t'i trajtojmë të nënshtruarit<sup>3</sup> sikur fajtorët?!

أَفَجَعَلِ الْمُسْلِمِينَ كَالْمُجْرِمِينَ ﴿٣٦﴾

37. “Çfarë keni ju?! Si gjykuakeni?!”

مَا لَكُمْ ۖ كَيْفَ تَحْكُمُونَ ﴿٣٧﴾

38. A keni ndonjë libër që e studioni?!

أَمْ لَكُمْ كِتَابٌ فِيهِ تَدْرُسُونَ ﴿٣٨﴾

39. Me siguri aty do të keni gjithçka që pëlqeni!

إِنَّ لَكُمْ فِيهِ لَمَا تَخَيَّرُونَ ﴿٣٩﴾

40. A keni premtime ndaj Nesh që Na kushtëzojnë deri në Ditën e Kiametit që ju të keni të drejtën të vendosni si të doni?!”

أَمْ لَكُمْ أَيْمَانٌ عَلَيْنَا بِالْعَقَّةِ إِلَىٰ يَوْمِ الْقِيَامَةِ ۗ إِنَّ لَكُمْ لَمَا تَحْكُمُونَ ﴿٤٠﴾

41. Pyeti, kush prej tyre është garant për këtë?

سَأَلَهُمْ أَيُّهُمْ بِذَٰلِكَ زَعِيمٌ ﴿٤١﴾

3. Muslimanët.



42. A kanë ortakë?<sup>4</sup> Atëherë le t'i sjellin ortakët e tyre, nëse janë të vërtetë.

أَمْ لَهُمْ شُرَكَاءٌ فَمَا يُؤْتُوا بِشُرَكَائِهِمْ إِنْ  
كَانُوا صَادِقِينَ ﴿٤٢﴾

43. Ditën kur gjëma do të dalë sheshit, dhe ata thirren për sexhde, por nuk do të kenë fuqi.

يَوْمَ يُكْشَفُ عَنْ سَاقٍ وَ يُدْعَوْنَ إِلَى  
السُّجُودِ فَلَا يَسْتَطِيعُونَ ﴿٤٣﴾

44. Sytë e tyre do të jenë të përlurur; poshtërimi do t'i mbulojë ata. Sigurisht, ata thirreshin për sexhde edhe atëherë kur ishin të shëndoshë.

خَاشِعَةً أَبْصَارُهُمْ تَرْهُقُهُمْ ذِلَّةٌ وَ قَدْ  
كَانُوا يُدْعَوْنَ إِلَى السُّجُودِ وَهُمْ سَلِيمُونَ ﴿٤٤﴾

45. Andaj, Më lër mua dhe atë që e quan gënjeshtër këtë Fjalë! Ne do t'i kapim ata shkallë-shkallë, prej nga nuk e presin.

فَذَرْنِي وَ مَنْ يُكَذِّبُ بِهَذَا الْحَدِيثِ  
سَنَسْتَدْرِجُهُمْ مِنْ حَيْثُ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٤٥﴾

46. Dhe Unë u jap lëshim, (por) sigurisht, plani Im është shumë i fortë.

وَ أَمِلْ لَهُمْ إِنَّا كِيدِي مَتِينٌ ﴿٤٦﴾

47. Mos po u kërkon ndonjë shpërblim, që ata të rëndohen nga barra e gjobës?!

أَمْ تَسْأَلُهُمْ أَجْرًا فَهُمْ مِنْ مَعْرُومٍ  
مُتَّفَلُونَ ﴿٤٧﴾

48. Apo zotëruakan të padukshmen, të cilën po e shkruajnë?!

أَمْ عِنْدَهُمُ الْعَيْبُ فَهُمْ يَكْتُمُونَ ﴿٤٨﴾

49. Duro për urdhrin e Zotit tënd dhe mos u bë si njeriu i peshkut, kur ai thirri (Zotin e tij) dhe ishte i mërzhitur.

فَاصْبِرْ لِحُكْمِ رَبِّكَ وَ لَا تُكُنْ كَصَاحِبِ  
الْحُوتِ إِذْ نَادَى وَهُوَ مَكْظُومٌ ﴿٤٩﴾

50. Po të mos e kishte shpëtuar atë një mirësi e Zotit të tij, ai do të hidhej në një shkretëtirë dhe do të mbetej i qortuar.

لَوْ لَا أَنْ تَدْرَكَهُ نِعْمَةٌ مِنْ رَبِّهِ لَنُبِذَ  
بِالْعُرَاءِ وَهُوَ مَذْمُومٌ ﴿٥٠﴾

4. Bëhet fjalë për ortakët që ata i kanë sajuar Zotit.

51. Pra, Zoti i tij e zgjodhi atë dhe e bëri ndër të dëlirët.

فَاجْتَبَاهُ رَبُّهُ فَجَعَلَهُ مِنَ الصَّالِحِينَ ﴿٥١﴾

52. Ata që mohuan, ka mundësi të tentojnë të të rrëzojnë ty me shikimin e tyre (të zemëruar) kur e dëgjojnë këshillën; dhe thonë: “Ky qenka i çmendur!”

وَإِنَّ يَكَاذِبَ الَّذِينَ كَفَرُوا لَيُرِيَنَّكَ  
بِأَبْصَارِهِمْ لَمَّا سَمِعُوا الذِّكْرَ وَيَقُولُونَ  
إِنَّهُ لَمَجْنُونٌ ﴿٥٢﴾

53. Kurse ai është vetëm një këshillë për (tërë) botët.

﴿٥٣﴾ وَمَا هُوَ إِلَّا ذِكْرٌ لِلْعَالَمِينَ ﴿٥٣﴾

## Surja 69 – El-Hakka

Surja El-Hakka është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka pesëdhjetë e tri ajete.

Në suren El-Kalem, Allahu tha: Kur Unë u jap lëshim kundërshtarëve të Profetëve, ata vijnë në mëkatet e tyre, derisa e mbushin kupën, atëherë askush nuk i shpëton dot nga ndëshkimi Im. Edhe kjo sure përmend disa popuj, të cilëve Allahu vazhdimisht u kishte dhënë lëshim, por kur edhe ata e mbushën kupën e mëkateve, u ndëshkuan.

Allahu i Madhërishëm e porositi Profetin Muhammed<sup>savs</sup> të paralajmërojë njeriun për një ndëshkim shumë të madh. Ky paralajmërim nuk ishte për ndonjë grup të caktuar fetar, por për tërë njerëzimin. Kur të vijë ai ndëshkim që në këtë botë, njeriut do t'i duket sikur i janë lëkundur toka e qielli. Kjo do të plotësohet edhe një herë në botën tjetër, kur njeriun mohues nuk do ta shpëtojë dot nga xhehenemi asnjë lidhje e tij, as tokësore e as qiellore.

Pas kësaj, Allahu i Madhërishëm paraqet një dëshmi të madhe në lidhje me përmbushjen jo vetëm të atyre çështjeve, të cilat edhe njeriu mund t'i parashikojë ndopak, por edhe të atyre çështjeve që janë përtej shikimit të tij. Pra, fjalët e Profetit Muhammed<sup>savs</sup> janë fjalët e një të Dërguari shumë të besueshëm e të nderuar, dhe se ato nuk janë as poezi të një poeti, e as hamendësime të ndonjë fallxhori. Kjo zbritje fjalësh në formë shpalljeje është nga Zoti i të gjitha botëve.

Për vërtetësinë e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, në fund të kësaj sureje, është paraqitur një provë e tillë që një njeri që beson në Zot, nuk mund ta rrëzojë dot atë. Duke iu drejtuar kundërshtarëve të Profetit<sup>savs</sup>, Allahu i Madhërishëm u thotë: Ju që thoni se Profeti e ka trilluar këtë Libër të nderuar, ndërkohë, po të trillonte qoftë disa fjalë në emër të Allahut, Allahu do ta shkatërronte tërësisht atë dhe grupin e tij, dhe në këtë rast, askush nga ju nuk mund ta shpëtonit dot atë prej Allahut. Me fjalë të tjera, përderisa Allahu i Madhërishëm po e ndihmon dhe e mbështet atë, pavarësisht nga përpjekjet maksimale të kundërshtarëve, të cilët me çdo kusht duan ta asgjësojnë atë, është një dëshmi e pathyeshme për vërtetësinë se ai është i Dërguari i Allahut. Pra, premtimi i Allahut që *“Unë dhe të Dërguarit e Mi patjetër do të triumfojmë!”* (58:22), edhe një herë u plotësua në mënyrë të qartë.

Ajetet:  
53سُورَةُ الْحَاقَّةِ  
69. EL-HAKKA  
MekaseRukutë:  
2

1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. E vërteta e pashmangshme!

الْحَاقَّةُ ①

3. Ç'është e vërteta e pashmangshme?

مَا الْحَاقَّةُ ②

4. E si mund ta dish ti se ç'është e vërteta e pashmangshme?

وَمَا آذْرَبِكَ مَا الْحَاقَّةُ ③

5. Themudët dhe adët e kishin quajtur gënjeshtër gjëmën tronditëse.

كَذَّبَتْ ثَمُودُ وَعَادٌ بِالْقَارِعَةِ ④

6. Për sa u përket themudëve, ata u shkatërruan me një ndëshkim të tejskajshëm.

فَأَمَّا ثَمُودُ فَأَهْلِكُوا بِالطَّاغِيَةِ ⑤

7. Dhe për sa u përket adëve, ata u shkatërruan me një erë të fortë, të rrembyeshme,

وَ أَمَّا عَادٌ فَأَهْلِكُوا بِرِيحٍ صَرْصَرٍ  
عَاتِيَةٍ ⑥

8. të cilën Ai e kishte vënë në punë kundër tyre si shkulëse për shtatë net e tetë ditë. Andaj, ti e sheh popullin në të tërësisht të mundur, sikur të jenë trungje të shkulura hurmash.

سَخَّرَهَا عَلَيْهِمْ سَبْعَ لَيَالٍ وَثَمَنِيَةَ أَيَّامٍ  
حُسُومًا ⑦ فَتَرَى الْقَوْمَ فِيهَا صَرْعَى  
كَأَنَّهُمْ أَحْجَارٌ مَّخْلُوعَةٌ ⑧

9. Pra, a sheh ndonjë të mbetur prej tyre?!

فَهَلْ تَرَى لَهُم مِّنْ بَاقِيَةٍ ⑨

10. Edhe Faraoni, edhe ata që ishin para tyre, edhe vendbanimet që u përmbysën erdhën me faj.

وَجَاءَ فِرْعَوْنُ وَمَنْ قَبْلَهُ وَالْمُؤْتَفِكَتُ  
بِالْحَاطِئَةِ ⑩

11. Ata e kundërshtuan të Dërguarin e Zotit të tyre, dhe Ai i zuri me një ndëshkim që vetëm shtohet.

فَعَصَوْا رَسُولَ رَبِّهِمْ فَأَخَذَهُمْ أَخَذَةً  
رَّابِيَةً ⑪

12. Kur uji u dallgëzua, Ne ju mbartëm në anije.

إِنَّا لَمَّا طَغَا الْمَاءُ حَمَلْنَاكُمْ فِي الْجَارِيَةِ ۝

13. Që atë t'jua bënim një shenjë përkujtuese, dhe që çdo vesh mbajtës ta mbajë (në kujtesë).

لِنَجْعَلَهَا لَكُمْ تَذْكِرَةً وَتَعِيهَا أَدْنَ ۝  
وَأَعْيَبَهَا ۝

14. Kur do t'i fryhet bririt me një frymë të vetme,

فَإِذَا نُفِخَ فِي الصُّورِ نَفْخَةٌ وَاحِدَةٌ ۝

15. dhe do të mbahen toka dhe malet, që (më pas) të thërrmohen përnjëherë,

وَ حُمِلَتِ الْأَرْضُ وَالْجِبَالُ فَدُكَّتَا دَكَّةً ۝  
وَاحِدَةً ۝

16. atë ditë do të ndodhë ndodhia,

فِيَوْمٍ وَّ قَعَتِ الْوَاقِعَةُ ۝

17. dhe qielli do të çahet, atë ditë ai do të jetë i brishtë,

وَأَنْشَقَّتِ السَّمَاءُ فَهِيَ يَوْمٍ وَّاهِيَةٌ ۝

18. dhe engjëjt do të qëndrojnë rreth e përçark tij, dhe atë ditë tetë (cilësi) do të mbartin Arshin e Zotit tënd.<sup>1</sup>

وَ الْمَلِكِ عَلَىٰ أَرْجَائِهَا ۝ وَيَحْمِلُ عَرْشَ رَبِّكَ فَوْقَهُمْ يَوْمَئِذٍ مُّنْبِئَةٌ ۝

19. Atë ditë ju do të paraqiteni. Asnjë fshehtësi nuk do t'ju mbetet e fshehtë.

يَوْمَئِذٍ تُعْرَضُونَ لَا تَخْفَىٰ مِنْكُمْ خَافِيَةٌ ۝

20. Atëherë ai të cilit do t'i jepet libri i tij në dorën e djathtë, do të thotë:

فَأَمَّا مَنْ أُوْتِيَ كِتَابَهُ بِيَمِينِهِ ۝ فَيَقُولُ

1. Nuk duhet të keqkuptoni nga ky ajet duke menduar se ndonjë forcë fizike e engjëjve do ta mbartka Arshin e Allahut. Arshi nuk është diçka fizike, që të nevojitet ndonjë forcë fizike për ta mbartur atë. Në të vërtetë, Allahu i Madhërishtëm mbart çdo gjë, pra çdo gjë po qëndron në këmbë me mbështetjen e Tij. *Hazret Imam Mehdiu*<sup>as</sup> thotë se Arshi është pozita e shenjtë dhe ekskluzive (*tenezzuh*) e Allahut, një gjendje e Tij e paarritshme për krijesat. Katër cilësi të përmendura në suren El-Fatiha, Krijuesi (*Rab*), i Gjithëmëshirshmi (*Rrahman*), Mëshirëbërësi (*Rrahim*) dhe Sunduesi i Kohës së Gjykimit (*Maliki Jeumiddin*), ndryshe janë qajtur katër engjëj. “Këto katër cilësi janë ato që e mbajnë Arshin. Pra, në këtë botë ne e njohim Qenien e Tij të Fshehtë përmes këtyre katër cilësive të Tij. Kjo njohje në botën tjetër do të dyfishohet. Me një fjalë, atë ditë engjëjt arshmbartës do të jenë jo katër, por tetë.” (*Hazret Mirza Ghulam Ahmed*, “Çeshma-e-Marifet”, “Ruhani Khazain”, vëll. 23, f. 279). Për Arshin, lexoni 7:55.

“Ja, merreni<sup>2</sup> librin tim dhe lexojeni!

هَٰؤُمْ أَقْرَأُوا كِتَابِيَهٗ ۝

21. Sigurisht, unë shpresoja që do ta shihja llogarinë time!”

إِنِّي ظَنَنْتُ أَنِّي مُلِقٌ حِسَابِيَهٗ ۝

22. Ai do të gëzojë jetë të pëlqyeshme

فَهُوَ فِي عِيشَةٍ رَّاضِيَةٍ ۝

23. në kopshte të larta

فِي جَنَّةٍ عَالِيَةٍ ۝

24. me vile të varura.

فُطُوفَهَا دَانِيَةٍ ۝

25. “Hani e pini lirshëm për shkak të atyre (veprave) që bënit në ditët e kaluara!”

كُلُوا وَاشْرَبُوا هَنِيئًا بِمَا أَسْلَفْتُمْ فِي الْأَيَّامِ

الْخَالِيَةِ ۝

26. Kurse ai të cilit do t'i jepet libri i tij në të majtën, do të thotë: “Mjerë unë! Sikur të mos më jepej libri im,

وَأَمَّا مَنْ أُوتِيَ كِتَابَهُ بِشِمَالِهِ ۖ فَيَقُولُ يُلَيِّتُنِي

لَمْ أُوتَ كِتَابِيَهٗ ۝

27. dhe as mos ta dija llogarinë time!

وَلَمْ أَدْر مَا حِسَابِيَهٗ ۝

28. Ah sikur të isha asgjësuar tërësisht!

يَلَيَّتَهَا كَانَتِ الْقَاضِيَةَ ۝

29. Pasuria ime nuk më vlejti;

مَا أَعْنَىٰ عَنِّي مَالِيَهٗ ۝

30. m'u shkatërrua (edhe) pushteti!”

هَلَكَ عَنِّي سُلْطَانِيَهٗ ۝

31. “Kapeni këtë dhe prangoseni në qafë.

خُذُوهُ فَغُلُّوهُ ۝

32. Më pas, flakeni në xhehenem.

ثُمَّ الْجَحِيمِ صَلُّوهُ ۝

33. Më pas, shtrëngojeni me zinxhir shtatëdhjetë kuta të gjatë!”<sup>3</sup>

ثُمَّ فِي سِلْسِلَةٍ ذَرْعُهَا سَبْعُونَ ذِرَاعًا

فَأَسْلُكُومُ ۝

2. Fjala arabe “hāumû”, hā do të thotë merr, dhe thuhet hāumû dhe hāumû. (Mufredatî i Imam Ragibit<sup>3</sup>)

3. Këto ajete tregojnë që ndëshkimi shpirtëror i kësaj bote, në botën tjetër do të shfaqet fizikisht. Pra, prangat në qafë ishin dëshirat tokësore të njeriut, që ia kishin rënduar kokën

34. Sigurisht, ai nuk besonte në Allahun e Madhërishëm

إِنَّهُ كَانَ لَا يُؤْمِنُ بِاللَّهِ الْعَظِيمِ ﴿٣٤﴾

35. dhe nuk nxiste për të ushqyer nevojtarët.

وَلَا يَحْضُ عَلَى طَعَامِ الْمَسْكِينِ ﴿٣٥﴾

36. Prandaj, sot ai nuk ka këtu asnjë shok të ngushtë,

فَلَيْسَ لَهُ الْيَوْمَ هُنَا حَمِيمٌ ﴿٣٦﴾

37. as edhe ushqim, përveç qelbit.

وَلَا طَعَامٌ إِلَّا مِنْ غَسَلِئِنِ ﴿٣٧﴾

38. Atë nuk e ha tjetërkush përveç fajtorëve.

لَا يَأْكُلُهُ إِلَّا الْخَاطِئُونَ ﴿٣٨﴾

39. Dëgjoni! Betohem për atë që shikoni!

فَلَا أَقْسِمُ بِمَا تُبْصِرُونَ ﴿٣٩﴾

40. Dhe për atë që nuk e shikoni!

وَمَا لَا تُبْصِرُونَ ﴿٤٠﴾

41. Kjo, pa dyshim, është fjalë e një të Dërguari të nderuar.

إِنَّهُ لَقَوْلُ رَسُولٍ كَرِيمٍ ﴿٤١﴾

42. Dhe ajo nuk është fjalë poeti. Sa pak që besoni!

وَ مَا هُوَ بِقَوْلِ شَاعِرٍ قَلِيلًا مَّا تُوْمِنُونَ ﴿٤٢﴾

drejt tokës. Kjo në botën tjetër do të shfaqet në një formë fizike. Po ashtu, prangat e kësaj bote do t'i duken si zinxhirë nëpër këmbë, kurse zjarri i dëshirave të kësaj bote, do t'i shfaqet si një zjarr flakërues. Në jetën e kësaj bote, njeriu i keq ushqen një ferr dëshirash dhe epshesh brenda vetes dhe në momente humbjesh, e ndien afshin e këtij ferri. Kështu që, kur Zoti do ta largojë atë nga epshet e tij të vdekshme dhe ai do të pësojë dëshpërime të përhershëm, Zoti i Madhërishëm atij do t'ia shfaqë këto dëshpërime në formën e një zjarri fizik. Siç Ai thotë: Mes tyre dhe mes gjërave që ata dëshironin, do të vihet një ndarje (34:55). Ky pikërisht do të jetë burimi i ndëshkimit. Ajo që u tha më sipër: "lidheni me një zinxhir, gjatësia e të cilit të jetë shtatëdhjetë kuta", gjithashtu tregon se një i lig nganjëherë arrin edhe moshën shtatëdhjetëvjeçare, madje nganjëherë, duke lënë mënjane vitet e fëmijërisë dhe pleqërinë e thellë, i jepet një jetë e shëndoshë dhe e plotë prej shtatëdhjetë vjetësh, e denjë për të treguar mençuri dhe për të bërë punë e përpjekje. Por ai si një fatlig i kalon të shtatëdhjetë vitet e mira të jetës së tij në prangat e kësaj bote, dhe nuk dëshiron të lirohet nga ato. Prandaj Zoti i Madhërishëm thotë në këtë ajet, që pikërisht ato shtatëdhjetë vite që ai kaloi në vargonjtë e kësaj bote, në botën e ringjalljes do t'i shfaqen si një zinxhir i gjatë shtatëdhjetë kuta. Një kut baras me një vit. Duhet të dimë që Zoti i Madhërishëm kurrë nuk i sjell vështirësi robit, përkundrazi, Ai ia vë përpara vetëm punët e këqija të tij. Lexoni edhe 76:5.

43. Dhe nuk është as fjalë fallxhori.  
Sa pak që pranoni këshillën!

وَلَا يَقُولُ كَاهِنٌ قَلِيلًا مَّا تَدَّكَّرُونَ ﴿٤٣﴾

44. (Ajo) është zbritje prej Zotit të botëve.

تَنْزِيلٌ مِّن رَّبِّ الْعَالَمِينَ ﴿٤٤﴾

45. Nëse ai do të kishte trilluar qoftë disa fjalë duke Na i atribuar Neve,

وَلَوْ تَقَوَّلَ عَلَيْنَا بَعْضَ الْأَقَاوِيلِ ﴿٤٥﴾

46. Ne patjetër do ta kapnim me të Djathtën Tonë,

لَا خَدْنَا مِنْهُ بِالْيَمِينِ ﴿٤٦﴾

47. më pas, do t'ia kishim prerë arterien e zemrës,

ثُمَّ لَقَطَعْنَا مِنْهُ الْوَتِينَ ﴿٤٧﴾

48. dhe askush prej jush nuk mund të (Na) pengonte dot kundër tij.<sup>4</sup>

فَمَا مِنْكُمْ مِّنْ أَحَدٍ عَنْهُ حَاجِزِينَ ﴿٤٨﴾

49. Dhe, sigurisht, ky është një mësim për të drujturit (ndaj Zotit).

وَإِنَّهُ لَتَذِكْرَةٌ لِّلْمُتَّقِينَ ﴿٤٩﴾

50. Ne e dimë që prej jush ka mohues,

وَإِنَّا لَنَعْلَمُ أَنَّ مِنْكُمْ مُّكَذِّبِينَ ﴿٥٠﴾

51. dhe ky (Kuran) është dëshpërim për mohuesit

وَإِنَّهُ لَحَسْرَةٌ عَلَى الْكٰفِرِينَ ﴿٥١﴾

52. dhe kjo është e vërteta e sigurt.

وَإِنَّهُ لِحَقِّ الْيَقِينِ ﴿٥٢﴾

53. Andaj, përkujto me emrin e Zotit tënd të Madhërishtëm!

يٰٓأَيُّهَا الْمُدَّثِّرُ ﴿٥٣﴾ قُمْ فَأَنذِرْ ۚ إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ ۚ فَسَبِّحْ بِحَمْدِ رَبِّكَ الْعَظِيمِ ﴿٥٤﴾

4. Ajetet 45 – 48 hedhin poshtë mendimin se profeti i rremë mund të shpëtojë nga ndëshkimi i Zotit përmes ndonjë ndihme tokësore. Në të vërtetë, profetët e rremë gjithmonë kanë mbrrapa ndonjë fuqi të kësaj bote, por megjithatë, ata dhe ndihmësit e tyre shkatërrohen. Andaj, kjo është një provë shumë e madhe e vërtetësisë së Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, sepse pas deklaratës së tij, e gjithë Arabia i kishte dalë kundër. Kurse ky ajet e shpjegon me qaf hollësi që sikur Profeti Muhammed<sup>savs</sup> të kishte trilluar qoftë një fjalë në emër të Zotit (*ma'adhallah*), dhe sikur Arabia të mos i kishte dalë kundër, madje ta kishte mbështetur atë, ata nuk mund ta kishin mbrojtur dot atë nga ndëshkimi i Allahut. [Kjo temë përmendet edhe në 17:74-76; 20:62; 6:22; 40:29.]



## Surja 70 – El-Mearixh

Surja El-Mearixh është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka dyzet e pesë ajete.

Që në ajetin e parë të kësaj sureje, Allahu i Madhërishëm paralajmëroi për një ndëshkim, të cilin mohuesit nuk mund ta ndalin dot.

Pas kësaj, Zoti është cilësuar si Zoti i Lartësive (*dhul-mearixh*), që do të thotë se duke studiuar universin, mund të kuptosh shkallë-shkallë Lartësitë e Tij deri në një pikë, përndryshe, askush nuk mund t'i rrokë dot ato. Kjo sure përmend një nga Lartësitë e Zotit, dhe njëherësh, sjell edhe një provë shkencore të saj duke thënë se engjëjt ngjiten te ajo pikë në një periudhë prej pesëdhjetë mijë vjetësh. Ngjitja në pesëdhjetë mijë vjet mund të ketë dy kuptime.

1) Ngjitja në pesëdhjetë mijë vjet siç i llogarisim ne. Edhe ky kuptim vërtetohet shkencërisht, sepse pas çdo pesëdhjetë mijë vjetësh, planeti i Tokës pëson ndryshime të tilla klimaterike, që e gjithë toka mbulohet me akullnaja, dhe pas një procesi, jeta fillon sërish nga e para.

2) Për kuptimin e dytë është me rëndësi të vërejmë që këtu nuk pohohet “*e barabartë me vite që llogaritni ju*”, siç është pohuar në ajetin nr. 6 të sures 32, Es-Sexhde, ajet i cili flet për një ditë të Zotit, të barabartë me një mijë vjet që llogarisim ne. Nëse të dyja këto ajete i lexojmë bashkë, kuptimi i tyre del: një mijë vjet të njerëzve, sipas një llogaritjeje, janë të barabarta me një ditë të Zotit. Nëse shumëzojmë një vit tonin me një mijë vjet, dhe pastaj shumëni që del ta shumëzojmë me pesëdhjetë mijë vjet, shuma që del përcakton ditët e Allahut që janë përmendur në këtë ajet. Kjo periudhë është rreth njëzet miliardë vjet, periudhë e cila, sipas shkencëtarëve është përafërsisht mosha e universit. ( $1000 \times 50000 \times 365 = 18,250,000,000$ ).

Pra, çdo univers pasi e arrin moshën e caktuar të tij, zhytet përsëri në asgjësim, dhe nga asgjësimi, Zoti e nis krijimin nga e para.

Kjo është një periudhë kaq e gjatë që njeriu në këtë botë nuk e rrok dot, por kur do të ndodhë ndëshkimi, njeriut do t'i duket se ky çast përfundimtar i ka ardhur shumë shpejt. Ndëshkimi do të jetë i tillë që njeriu do të dëshirojë të shpëtojë prej tij, qoftë duke dhënë si shpëtim jetën e tij, të afërmit e tij dhe krejt pasurinë e tij, por nuk do të mund të shpëtojë dot. Por përpara se të ndodhë ndëshkimi, Zoti do t'i shpëtojë prej tij ata besimtarë, të cilët lartësojnë namazin dhe gjithnjë shqetësohen për pastërtinë e tyre shpirtërore, duke zbatuar të gjitha porositë dhe duke plotësuar të gjitha kushtet që janë domosdoshmëri për pastrimin shpirtëror.

Në ajetin nr. 42, edhe një herë tjetër Allahu thotë: Allahu është i Pavarur nga ju, andaj nëse nuk tërhiqeni nga mosbindja dhe nga ligësitë, Ai është i Plotfuqishëm t'ju zëvendësojë me një krijim të ri. Kështu që, kjo sure mbyllet me përmendjen e të njëjtit ndëshkim, për të cilin paralajmëroi në hapjen e saj.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithë-mëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Një pyetës pyeti për ndëshkimin që do të bjerë.

سَأَلَ سَائِلٌ بِعَذَابٍ وَاقِعٍ ②

3. Asgjë nuk mund ta largojë atë nga mohuesit.

لِّلْكَافِرِينَ لَيْسَ لَهُ دَافِعٌ ③

4. (Ai është) prej Allahut, Zotëruesit të lartësive.

مِّنَ اللَّهِ ذِي الْمَعَارِجِ ④

5. Engjëjt dhe Shpirti ngjiten drejt Tij në një ditë, e cila është e barabartë me pesëdhjetë mijë vjet.

تَعْرُجُ الْمَلَائِكَةُ وَالرُّوحُ إِلَيْهِ فِي يَوْمٍ  
كَانَ مِقْدَارُهُ خَمْسِينَ أَلْفَ سَنَةٍ ⑤

6. Andaj duro, me durim të denjë!

فَاصْبِرْ صَبْرًا جَمِيلًا ⑥

7. Ata e shohin të largët,

إِنَّهُمْ يَرَوْنَهُ بَعِيدًا ⑦

8. por Ne e shohim të afërt.

وَنَرَاهُ قَرِيبًا ⑧

9. Ditën kur qielli do të bëhet porsì bakër i shkrirë;

يَوْمَ تَكُونُ السَّمَاءُ كَالْمُهْلِ ⑨

10. malet do të bëhen si lesh i shprishur;

وَتَكُونُ الْجِبَالُ كَالْعِهْنِ ⑩

11. dhe asnjë shok nuk do të pyesë për ndonjë shok (të tij).

وَلَا يَسْأَلُ حَمِيمٌ حَمِيمًا ⑪

12. (Edhe pse) ata do të vendosen në sy të njëri-tjetrit. Fajtori do të dëshirojë që sikur të jepte si shpagim për të shpëtuar nga ndëshkimi i asaj dite djemtë e tij,

يُبْصِرُ وَيَصْرُوهُمْ ⑫ يَوَدُّ الْمُجْرِمَ لَوْ يَفْتَدِي مِنْ  
عَذَابِ يَوْمٍ مِّدِّ بَيْنِيهِ ⑬

13. gruan e tij, vëllain e tij

وَصَاحِبَتِهِ وَأَخِيهِ ۝١٣

14. dhe, (edhe) fisin e tij që e strehonte,

وَفَصِيلَتِهِ الَّتِي تُؤْوِيهِ ۝١٤

15. dhe çdokënd që është në tokë, vetëm të shpëtonte prej atij (ndëshkimi).

وَمَنْ فِي الْأَرْضِ جَمِيعًا ۗ ثُمَّ يُنْجِيهِ ۝١٥

16. Por jo! Sigurisht, ai është flaka e zjarrit,

كَلَّا ۗ إِنَّهَا لَطِيلٌ ۝١٦

17. që e shkul lëkurën,

نَزَّاعَةً لِّلشَّوْىِ ۝١٧

18. thërret çdokënd që e ktheu shpinën dhe u shmang,

تَدْعُوا مِّنْ أَدْبَرَ وَتَوَلَّىٰ ۝١٨

19. dhe (që) grumbulloi (pasurinë), dhe (e) magazinoi.

وَجَمَعَ فَأَوْحَىٰ ۝١٩

20. Pa dyshim, njeriu është krijuar shumë lakmitar.

إِنَّ الْإِنْسَانَ خُلِقَ هَلُوعًا ۝٢٠

21. Kur e prek e keqja, vajton shumë,

إِذَا مَسَّهُ الشَّرُّ جَزُوعًا ۝٢١

22. dhe kur e prek e mira, bëhet tepër koprrac.

وَإِذَا مَسَّهُ الْخَيْرُ مَنُوعًا ۝٢٢

23. Por jo ata që falin namazin,

إِلَّا الْمَصَلِينَ ۝٢٣

24. që i kryejnë me vazhdimësi namazet e tyre,

الَّذِينَ هُمْ عَلَىٰ صَلَاتِهِمْ دَائِمُونَ ۝٢٤

25. të cilët në pasuritë e tyre ka pjesë

وَالَّذِينَ فِي أَمْوَالِهِمْ حَقٌّ مَّعْلُومٌ ۝٢٥

26. edhe lypësi, edhe ata (nevojtarë) që nuk lypin,

لِّلسَّالِئِلِ وَالْمَحْرُومِ ۝٢٦

27. dhe të cilët vërtetojnë Ditën e Gjykimit,

وَالَّذِينَ يُصَدِّقُونَ يَوْمَ الدِّينِ ۝٢٧

28. dhe që frikësohen nga ndëshkimi i Zotit të tyre.

وَالَّذِينَ هُمْ مِنْ عَذَابِ رَبِّهِمْ  
مُشْفِقُونَ ﴿٢٨﴾

29. Sigurisht, ndëshkimi i Zotit të tyre është i pashmangshëm.

إِنَّ عَذَابَ رَبِّهِمْ غَيْرُ مَأْمُونٍ ﴿٢٩﴾

30. Dhe ata që ruajnë organet e tyre intime,

وَالَّذِينَ هُمْ لِفُرُوجِهِمْ حَافِظُونَ ﴿٣٠﴾

31. përveçse me bashkëshortet e tyre dhe me ato që i kanë në zotërim; sigurisht, ata nuk do të qortohen;

إِلَّا عَلَىٰ أَرْوَاحِهِمْ أَوْ مَا مَلَكَتْ أَيْمَانُهُمْ  
فَأِنَّهُمْ غَيْرُ مَلُومِينَ ﴿٣١﴾

32. por ata që kërkojnë përtej kësaj, pa dyshim, janë shkelës.

فَمَنْ ابْتغَىٰ وَرَاءَ ذَلِكَ فَأُولَٰئِكَ هُمُ  
الْعَادُونَ ﴿٣٢﴾

33. Dhe ata që i ruajnë amanetet dhe zotimet e tyre,

وَالَّذِينَ هُمْ لِأَمْتِهِمْ وَعَهْدِهِمْ رِعُونَ ﴿٣٣﴾

34. dhe që qëndrojnë pas dëshmive të tyre,

وَالَّذِينَ هُمْ بِشَهَادَتِهِمْ قَائِمُونَ ﴿٣٤﴾

35. dhe që u rrinë roje namazeve të tyre,

وَالَّذِينَ هُمْ عَلَىٰ صَلَاتِهِمْ يُحَافِظُونَ ﴿٣٥﴾

36. pikërisht këta do të nderohen në xhenete.

﴿٣٦﴾ أُولَٰئِكَ فِي جَنَّاتٍ مُّكْرَمُونَ ﴿٣٦﴾

37. Çfarë u ndodhi atyre që mohuan, që te ti vijnë me vrap,

فَمَالِ الَّذِينَ كَفَرُوا قِبَلَكَ مُهْطِعِينَ ﴿٣٧﴾

38. tufa-tufa nga e djathta e nga e majta!

عَنِ الْيَمِينِ وَعَنِ الشِّمَالِ عِزِينَ ﴿٣٨﴾

39. Secili prej tyre a lakmon të hyjë në xhenete plot bekime?!

أَيُّطَمَعُ كُلُّ امْرِئٍ مِنْهُمْ أَنْ يُدْخَلَ جَنَّةَ  
نَعِيمٍ ﴿٣٩﴾

40. Kurrsesi! Ne i krijuam prej asaj gjëje që ata e dinë.

كَلَّا ۗ إِنَّا خَلَقْنَاهُمْ مِمَّا يَعْلَمُونَ ﴿٤٠﴾

41. Beto hem në Zotin e lindjeve dhe të perëndimeve! Ne, pa dyshim, jemi të Plotfuqishëm,

فَلَا أُقْسِمُ بِرَبِّ الْمَشْرِقِ وَالْمَغْرِبِ إِنَّا  
لَقَدِيرُونَ ﴿٤١﴾

42. që t'i zëvendësojmë ata me (njerëz) më të mirë, dhe askush nuk mund të Na parakalojë dot.<sup>1</sup>

عَلَىٰ أَنْ تُبَدَّلَ خَيْرًا مِنْهُمْ ۗ وَمَا نَحْنُ  
بِمَسْبُوقِينَ ﴿٤٢﴾

43. Andaj, lëri të merren me kotësi e lojëra, gjersa ta shohin ditën e tyre që u është premtuar.

فَذَرَهُمْ يَخُوضُوا وَيَلْعَبُوا حَتَّىٰ يَأْتُوا  
يَوْمَهُمُ الَّذِي يُوعَدُونَ ﴿٤٣﴾

44. Ditën kur ata do të dalin me shpejtësi nga varret, sikur nxitohen drejt një altari.

يَوْمَ يَخْرُجُونَ مِنَ الْأَجْدَاثِ سِرَاعًا  
كَأَنَّهُمْ إِلَىٰ نُصَبٍ يُّوفُّصُونَ ﴿٤٤﴾

45. Ndërkohë shikimet do t'i kenë të përlura dhe ata do të jenë të pushtuar nga poshtërimi. Kjo është dita që u premtohet.

خَاشِعَةً أَبْصَارُهُمْ تَرْهَقُهُمْ ذِلَّةٌ ۗ ذَٰلِكَ  
يَوْمَ الَّذِي كَانُوا يُوعَدُونَ ﴿٤٥﴾

1. Ajetet 41 – 42: Paraqitet dëshmia e Zotit të lindjeve dhe të perëndimeve, gjë që përbën një profeci që në të ardhmen njerëzimi edhe në gjuhën e tij do të përdorte shumë termat lindje e perëndime, siç po ndodh sot, për shembull, Lindja e Mesme, Lindja e Afërt, Lindja e Largët. Së dyti, ky ajet pohon diçka të jashtëzakonshme, sepse thotë se Allahu i Madhërishëm nëse do, është i Plotfuqishëm të sjellë në këtë botë një krijim më të mirë sesa njerëzit ekzistues.

## Surja 71 – Nuh

Surja Nuh është zbritur në vitet e para të periudhës mekase dhe, bashkë me *bismillahin*, ka njëzet e nëntë ajete.

Në fund të sures paraardhëse, Allahu i Madhërishëm pohoi: Ne jemi të Plotfuqishëm të sjellim njerëz më të mirë se ju. Në këtë sure jep shembullin e ndëshkimit që i erdhi popullit të Nuhut, pasi në një plan të vogël, edhe ai ndëshkim kishte të njëjtin funksion. Pra, i gjithë populli u fundos, me përjashtim të disa njerëzve, të cilët kishin marrë strehë në Arkën e Nuhut<sup>as</sup>. Më pas, prej këtyre njerëzve që shoqëronin Hazret Nuhun<sup>as</sup>, filloi një brezni e re, më e mirë se e mëparshmeja.

Ajeti nr. 5 përmend *exhelin*, pra caktimin e vendosur nga Allahu, që kur të vijë ai, askush nuk mund ta ndalë atë, temë e cila gjithashtu u mbart nga surja e mëparshme.

Më pas, kjo sure na sjell kumtimet dhe përgjërimet e Hazret Nuhut<sup>as</sup>, duke treguar se Zoti dërgon të Dërguarin e Tij, jo thjesht për të kumtuar mesazhin, por për të treguar që i Dërguari bëhet gati të vetëflijohet në përpjekjet e tij për t'ia kumtuar mesazhin Hyjnor popullit të vet. Pra, ai nuk lë mjet pa përdorur për të këshilluar të mëdhenjtë e të vegjlit e popullit. I përgjëron, i këshillon, herë fshehtas, në mënyrë që mendjemëdhenjtë të mos ndihen të turpëruar përpara njerëzve të zakonshëm, dhe herë haptas, në mënyrë që edhe të zakonshmit ta marrin mesazhin drejtpërdrejt nga Profeti i tyre, pasi prijësit e tyre ua japin gjithmonë të deformuar. Profeti i këshillon herë duke u dhënë shpresë – Nëse do të besoni, qielli si shi do t'ju lëshojë bekime dhe mëshirë, – dhe herë duke i alarmuar – Nëse nuk do të bëheni besimtarë, qielli në vend të mëshirës, do t'ju lëshojë një shi shkatërrimtar në atë mënyrë që edhe toka nuk do t'ju shpëtojë dot, madje edhe ajo do të hapë gurrat e shkatërrimit për ju. Ky pikërisht quhet *plotësim i argumenteve*, dhe Allahu pasi ua plotësoi argumentet, i zhduku nga faqja e dheut, për të hedhur më pas themelet e një breznie të re.

Andaj, kur Hazret Nuhu<sup>as</sup> u lut – O Zot, mos lër të gjallë asnjë nga mohuesit – iu lut sepse vetë Zoti i Madhërishëm i kishte dhënë dije që ata njerëz po u mbajtën të gjallë, do të lindnin vetëm të ligj dhe të pabindur. Pra, nuk kishte më asnjë shpresë që ata të krijonin një shoqëri besimtare. Andaj, xhematet e Zotit kur e plotësojnë detyrën e argumentimit ndaj kundërshtarëve, u lind e drejta për t'i kërkuar Zotit mallkimin ndaj kundërshtarëve.

Përveç kësaj, kjo sure gjithashtu pohon se Hazret Nuhu<sup>as</sup> i tha popullit të tij:

Pse nuk mendoni që Zoti juaj gëzon urtësinë? Ai pikërisht ju krijoi shkallë-shkallë dhe ju solli drejt përsosurisë. A nuk shikoni se kjo provohet edhe nga lartësitë e shtresëzuara të qiellit?!

Këtë temë populli i Nuhut mund ta kuptonte shumë pak, pasi ata nuk kishin dije të mjaftueshme as për të kaluarën e tyre sesi ata kishin evoluar shkallë pas shkalle, dhe as për të ardhmen e tyre. Po kështu, ata nuk kishin aspak njohuri as për lartësitë e

shtresëzuara të qiellit. Andaj, kjo mund të jetë edhe një profeci që në të ardhmen kur do të ndërtohet një “Arkë e re e Nuhut”, njerëzit e asaj kohe do ta kishin gjithë informacionin e nevojshëm për t’i kuptuar këto çështje. Dhe kur do të plotësohet detyra e argumentimit ndaj tyre, dhe prapëseprapë, nëse ata nuk tërhiqen nga “idhujtaria” e tyre, do të pranohet lutja e besimtarëve të asaj kohe që do t’i kërkojnë Zotit: “Shtypi ata tërësisht!” dhe “Mos lër mbi tokë asnjë keqbërës nga mohuesit!”



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Pa dyshim, Ne dërguam Nuhun te populli i tij që: “Paralajmëroje popullin tënd përpara se atyre t’u vijë një ndëshkim i dhimbshëm!”

إِنَّا أَرْسَلْنَا نُوحًا إِلَىٰ قَوْمِهِ أَنْ أَنْذِرْ قَوْمَكَ مِنْ قَبْلِ أَنْ يَأْتِيَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ ①

3. Ai tha: “O populli im, unë për ju jam një alarmues i qartë.

قَالَ يَقَوْمِ إِنِّي لَكُمْ نَذِيرٌ مُّبِينٌ ①

4. Adhuroni Allahun, kini druajtje ndaj Tij dhe mua më ndiqni.

إِنِ اعْبُدُوا اللَّهَ وَاتَّقُوهُ وَأَطِيعُوا ①

5. Ai do t’ju falë mëkatet dhe do t’ju japë lëshim deri në një afat të caktuar. Sigurisht, caktimi i Allahut kur vjen, nuk shtyhet më. Sikur ta dinit!”

يَغْفِرْ لَكُمْ مِنْ ذُنُوبِكُمْ وَيُؤَخِّرْكُمْ إِلَىٰ أَجَلٍ مُّسَمًّى ۗ إِنَّ أَجَلَ اللَّهِ إِذَا جَاءَ لَا يُؤَخَّرُ ۗ لَوْ كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ ①

6. Tha: “O Zoti im! Unë e thirra popullin tim ditë e natë.

قَالَ رَبِّ إِنِّي دَعَوْتُ قَوْمِي لَيْلًا وَنَهَارًا ①

7. Por thirrja ime vetëm se i largoi ata edhe më shumë.

فَلَمْ يَزِدْهُمْ دُعَائِي إِلَّا فِرَارًا ①

8. Dhe çdoherë kur i kam thirrur që Ti t’i falje, ata i vunë gishtërinjtë në veshët e tyre, e mbuluan veten me petkat e tyre, u treguan kokëfortë dhe tepër mendjemëdhenj.

وَإِنِّي كُلَّمَا دَعَوْتُهُمْ لِتَغْفِرَ لَهُمْ جَعَلُوا أَصَابِعَهُمْ فِي آذَانِهِمْ وَاسْتَغْشَوْا ثِيَابَهُمْ وَأَصْرُوا وَاسْتَكْبَرُوا وَاسْتَكْبَرُوا ①

9. Pastaj i thirra edhe me zë të lartë,

ثُمَّ إِنِّي دَعَوْتُهُمْ جِهَارًا ①

10. Më pas, i njoftova edhe haptas, u fola edhe fshehtas.

ثُمَّ إِنِّي أَعْلَنْتُ لَهُمْ وَأَسْرَرْتُ لَهُمْ إِسْرَارًا ①



11. Dhe u thashë: Kërkojini falje Zotit tuaj, sigurisht, Ai është shumë Falës;

فَقُلْتُ اسْتَغْفِرُوا رَبَّكُمْ إِنَّهُ كَانَ  
عَفَّارًا ﴿١١﴾

12. Ai do të dërgojë qiellin që do t'ju reshë,

يُرْسِلِ السَّمَاءَ عَلَيْكُمْ مِدْرَارًا ﴿١٢﴾

13. do t'ju ndihmojë me pasuri e fëmijë, do të bëjë për ju pemishte dhe do të bëjë (edhe) lumenj.

وَيُمِدُّكُمْ بِأَمْوَالٍ وَأَوْلَادٍ وَيَجْعَلُ  
لَكُمْ جَنَّاتٍ وَيَجْعَلُ لَكُمْ أَنْهَارًا ﴿١٣﴾

14. Çfarë keni që nuk prisni urtësinë prej Allahut?

مَا لَكُمْ لَا تَرْجُونَ لِلَّهِ وَقَارًا ﴿١٤﴾

15. Kurse Ai ju krijoi në etapa.

وَقَدْ خَلَقَكُمْ أَطْوَارًا ﴿١٥﴾

16. A nuk e keni parë sesi Allahu krijoi shtatë qiej në shtresa?

أَلَمْ تَرَوْا كَيْفَ خَلَقَ اللَّهُ سَبْعَ سَمَوَاتٍ  
طَبَاقًا ﴿١٦﴾

17. Dhe bëri hënën dritë në to, dhe diellin e bëri llambë të shndritshme.

وَجَعَلَ الْقَمَرَ فِيهِنَّ نُورًا وَجَعَلَ الشَّمْسَ  
سِرَاجًا ﴿١٧﴾

18. Dhe Allahu ju rriti prej tokës pors bimët.

وَاللَّهُ أَنْبَتَكُمْ مِنَ الْأَرْضِ نَبَاتًا ﴿١٨﴾

19. Pastaj do t'ju kthejë në të, dhe do t'ju nxjerrë në mënyrë të re.<sup>1</sup>

ثُمَّ يُعِيدُكُمْ فِيهَا وَيُخْرِجُكُمْ إِخْرَاجًا ﴿١٩﴾

1. Ajetet 14 – 19 flasin për krijimin e njeriut që ndodhi në etapa të ndryshme. Ata që mendojnë se Allahu i Madhërisëm krijoi gjithçka në një çast të vetëm, sipas këtyre ajeteve, e mohojnë urtësinë e Tij. Në të vërtetë, një që është i urtë, asnjëherë nuk është në nxitim, përkundrazi, ai vendos çdo gjë shkallë-shkallë. Në të njëjtën mënyrë, Allahu i Madhërisëm që është burimi i Urtësisë, i krijoi qiejt në shtresa të ndryshme.

Ajeti nr. 18 pohon: “Allahu ju rriti prej tokës pors bimët”, dhe kjo nuk është thënë në gjuhë të figurshme, përkundrazi, jeta e njeriut me të vërtetë ka kaluar faza të tilla kur ajo ishte në gjendje bimësie. Duke e përshkruar këtë fazë të jetës së tij, në një ajet tjetër, Zoti thotë: “nuk ishte diçka që mund të përmendej” (76:2). Pra, jeta e njeriut ka qenë në një fazë kur ajo nuk mund të përmendej dot. Nga ana tjetër, kjo paraqet idenë e hollë që jeta e njeriut kur ishte në fazë bimësie, ajo nuk kishte aftësi për të bërë zë dhe as për të dëgjuar, si të thuash, në të mbretëronte një heshtje absolute.

20. Dhe Allahu bëri për ju tokën si shtrat.

وَاللَّهُ جَعَلَ لَكُمْ الْأَرْضَ بِسَاطًا ۝

21. Që ju të ecni në rrugët e gjera të saj.”

﴿ تَسْلُكُوا مِنْهَا سُبُلًا فِجَاجًا ۝

22. Nuhu tha: “O Zoti im! Pa dyshim, ata më kundërshtuan mua, dhe ndoqën atë, i cili ua shtoi pasurinë dhe fëmijët vetëm për t’i çuar në humbje.

قَالَ نُوحٌ رَبِّ إِنَّهُمْ عَصَوْنِي وَاتَّبَعُوا  
مَنْ لَمْ يَزِدْهُ مَالَهُ وَوَلَدَهُ إِلَّا خَسَارًا ۝

23. Ata bënë komplot të madh.

وَمَكَّرُوا مَكْرًا كُبَارًا ۝

24. Dhe thanë: ‘Kurrë mos i lini të adhuroarit tuaj dhe kurrë mos braktisni as Veddain, as Suvain, as Jeguthin, as Jeukun e as Nesrain.’

وَقَالُوا لَا تَدْرُنَّ إِلَهَتَكُمْ وَلَا تَدْرُنَّ وَدًّا  
وَلَا سُوعَاءً وَلَا يَعُوتٌ وَيَعُوقٌ وَسَرًّا ۝

25. Dhe devijuan shumë të tjerë. (O Zot), keqbërësve shtojua vetëm humbje!”

وَقَدْ أَضَلُّوا كَثِيرًا ۖ وَلَا تَزِدِ الظَّالِمِينَ إِلَّا  
ضَلَالًا ۝

26. Për shkak të mëkateve të tyre ata u fundosën, më pas hynë në zjarr. Pra, duke e lënë Allahun, nuk gjetën askënd tjetër si ndihmës.

مِمَّا خَطَبْتَهُمْ أُغْرِقُوا فَأَدْخَلُوا نَارًا ۖ فَلَمْ  
يَجِدُوا لَهُمْ مِنْ دُونِ اللَّهِ أَنْصَارًا ۝

27. Dhe Nuhu tha: “O Zoti im! Mos lër të banojë në tokë asnjë nga mohuesit!

وَقَالَ نُوحٌ رَبِّ لَا تَذَرْ عَلَى الْأَرْضِ  
مِنَ الْكٰفِرِينَ دَيَّارًا ۝

28. Po i le ata, ata patjetër do të devijojnë robërit e Tu dhe nuk do të lindin përveçse imoral (dhe) mohues.<sup>2</sup>

إِنَّكَ إِنْ تَذَرَهُمْ يُضِلُّوا عِبَادَكَ وَلَا  
يَلِدُوا إِلَّا فٰجِرًا كَفَّارًا ۝

2. Mallkimi i Hazret Nuhut<sup>as</sup> kundër popullit të tij që është përmendur në ajetet 27 – 28, në fakt, erdhi për shkak se Allahu i Madhërishëm e kishte njoftuar atë që ky popull dhe pasardhësit e tyre nuk do të besonin më. Hazret Nuhu<sup>as</sup> vetë nuk mund ta dinte dot këtë,

29. O Zoti im! Më fal mua dhe prindërit e mi dhe këdo që hyri në shtëpinë time si besimtar dhe të gjithë besimtarët e besimtare! Ndërsa, keqbërësve shtojua vetëm rrënimin!”

رَبِّ اغْفِرْ لِي وَلِوَالِدَيَّ وَلِمَنْ دَخَلَ بَيْتِي  
 مُؤْمِنًا وَلِلْمُؤْمِنِينَ وَالْمُؤْمِنَاتِ ۗ وَلَا تَزِدِ  
 الظَّالِمِينَ إِلَّا تَبَارًا ۝

andaj, ai me siguri u vu në dijeni prej Allahut të Madhërishëm, dhe atëherë e bëri këtë lutje mallkuese. (Lexoni 11:37)

## Surja 72 – El-Xhinn

Surja El-Xhinn është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka njëzet e nëntë ajete.

Një lidhje e kësaj sureje me suren paraardhëse është se edhe kjo sure i jep lajm të mirë popullit: nëse do ta pranoni mesazhin, qielli do t'ju lëshojë ujë mëshire me bollëk, përndryshe, do të përfshihen në një ndëshkim që vetëm do të shtohet. Edhe përmbytja që u përmend në suren Nuh, ishte një përmbytje që sa vinte e shtoej.

Le t'i hedhim kësaj sureje një shikim të përgjithshëm mbi disa nga temat e saj. Ndër to janë disa çështje që lidhen me xhindët. Dijetarët në përgjithësi mendojnë se xhindët këtu do të thotë një krijesë tjetër e padukshme, e krijuar prej zjarri, ndërkohë, hadithet autentike provojnë që i Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> takoi një delegacion, të cilët u cilësuan xhindë për shkak se ishin prijës të popullit të tyre, dhe duke pritur Profetin<sup>savs</sup> ata, si gjithë njerëzit e tjerë, kishin ndezur zjarr për të gatuar ushqime etj.. Pra, këtu nuk flitet aspak për të ashtuquajturit xhindë të përftyruar.

Po kështu, duke diskutuar çështjet e tyre, ata thanë – Mes nesh ka nga ata mendjelehtë që i atribuojnë Allahut gjëra të padenja, dhe ne kishim krijuar një bindje të gabuar që më Allahu nuk do të dërgonte ndonjë Profet. Ata vërtetuan që këto gjëra ishin të gabuara, sepse tashmë e kishin parë me sy një Profet madhor.

Pas kësaj, në lidhje me xhamitë, kjo sure pohon që ato ndërtohen tërësisht për hir të Allahut, ku nuk duhet adhuruar asgjë e askush tjetër përveç Tij. Më pas, përmend mënyrën e adhurimit të Profetit Muhammed<sup>savs</sup> dhe që gjatë adhurimit, atë e rrethonin brenga e shqetësime nga më ndryshmet për t'ia larguar atij përqendrimin, por megjithatë, ai ia përkushtonte përqendrimin e vet tërësisht Allahut. Por njerëzit e zakonshëm vërejnë në jetën e tyre të përditshme që gëzimet dhe brengat shpesh ua largojnë përqendrimin e tyre nga adhurimi.

Këtu edhe njëherë u përsërit që për ndëshkimin të cilin e shikoni të largët, askush nuk mund të pohojë se është i largët apo i afërt. Kur do të vijë ndëshkimi, njeriu patjetër do ta ketë përballë, sado të largët mund ta ketë menduar.

Allahu i Madhërishëm i dhuroi me shumicë Profetit Muhammed<sup>savs</sup> njohuritë e së padukshmes. Profeti<sup>savs</sup> vetë nuk ishte i ditur për botën e padukshme, por është praktikë e Allahut që Ai u tregon të Dërguarve të Tij një pjesë të saj. Pra, Profetët nuk e fitojnë dijen e së padukshmes me përpjekjet e tyre, por Zoti ua tregon, dije e cila shpesh përbëhet nga profecitë që përmbushen pashmangshmërisht. Në këtë proces, engjëjt i qëndrojnë roje shpalljes Hyjnore nga para dhe nga mbrapa, në mënyrë që djajtë të mos kenë asnjë qasje për të ndërhyrë. Në të njëjtën mënyrë, pas të Dërguarve madhorë të Allahut, vijnë të Dërguar të tjerë duke qenë shërbëtorë të tyre, të cilët caktohen me përgjegjësi për të ruajtur kuptimet e shpalljes Hyjnore.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ۝

2. Thuaj: Mua më është shpallur që një grup i xhindëve dëgjoji me vëmendje (Kuranin) dhe thanë: “Ne me të vërtetë dëgjuam një Kuran të çuditshëm!

قُلْ أُوْحِيَ إِلَيَّ أَنَّهُ اسْتَمَعَ نَفَرٌ مِّنَ الْجِنِّ فَقَالُوا إِنَّا سَمِعْنَا قُرْآنًا عَجَبًا ۝

3. Që udhëzon drejt mirësisë, andaj e besuam. Dhe ne kurrësi nuk do të bëjmë dikë ortak me Zotin tonë.”

يَهْدِي إِلَى الرُّشْدِ فَآمَنَّا بِهِ ۖ وَلَنْ نُشْرِكَ بِرَبِّنَا أَحَدًا ۝

4. Dhe (thanë): “Sigurisht, e lartë është madhështia e Zotit tonë; Ai nuk mori as grua, e as bir.

وَأَنَّهُ تَعَلَّى جَدُّ رَبِّنَا مَا اتَّخَذَ صَاحِبَةً وَلَا وَلَدًا ۝

5. Dhe se mendjelehti ynë thoshte fjalë tërësisht të padenja për Allahun.

وَ أَنَّهُ كَانَ يَقُولُ سَفِيهُنَا عَلَى اللَّهِ شَطَطًا ۝

6. Dhe ne mendonim se njeriu e xhindi kurrë nuk mund të flasin gënjeshtër mbi Allahun.

وَ إِنَّا ظَنَنَّا أَن لَّن نَّقُولَ الْإِنس وَالْجِنِّ عَلَى اللَّهِ كَذِبًا ۝

7. Dhe se kishte burra prej njerëzve të zakonshëm, të cilët u kërkonin mbrojtje burrave xhindë (pra, të fortëve), andaj (të parët) i shtuan këta në rebelim dhe mëkate.<sup>1</sup>

وَ أَنَّهُ كَانَ رِجَالٌ مِّنَ الْإِنس يَعُوذُونَ بِرِجَالٍ مِّنَ الْجِنِّ فَزَادُوهُمْ رَهَقًا ۝

8. Dhe ata menduan siç e keni menduar ju që Allahu më kurrë nuk do të dërgojë dikë.

وَ أَنَّهُمْ ظَنُّوا كَمَا ظَنَنْتُمْ أَن لَّن نَّبْعَثَ اللَّهَ أَحَدًا ۝

1. Shumë nga njerëzit e thjeshtë jetojnë nën ndikimin e njerëzve të fuqishëm, gjë që i bën këta të fundit mendjemdhënj dhe rebelë. Kështu, ky ajet e sqaron se cilët janë “xhindë” karshi njerëzve. Lexoni edhe 34:42 dhe 6:129.

9. Dhe sigurisht, ne prekëm qiellin, të cilin e gjetëm të mbushur me mbrojtës të fortë dhe me flakë (të shumta).

وَإِنَّا لَمَسْنَا السَّمَاءَ فَوَجَدْنَاهَا مُلْتَأَةً فَحَرَسًا  
شَدِيدًا وَشُهُبًا ۝١

10. Dhe ne rrinim ulur në disa nga vendet e tij për të dëgjuar. Por tani kushdo që tenton të dëgjojë, gjen në pritë një flakë zjarri.<sup>2</sup>

وَإِنَّا كُنَّا نَقْعُدُ مِنْهَا مَقَاعِدَ لِلسَّمْعِ ۖ فَمَنْ يَسْتَمِعِ الْآنَ يَحِذِّ لَهُ شَهَابًا رَصَدًا ۝٢

11. Dhe ne nuk dinim a ishte synuar e keqja për të gjithë ata që janë në tokë, apo Zoti i tyre dëshiroi mirësi për ta.

وَإِنَّا لَا نَذَرِيْ أَسْرًا أُرِيْدَ بِمَنْ فِي الْأَرْضِ أَمْ أَرَادَ بِهِمْ رَبُّهُمْ رَشَدًا ۝٣

12. Dhe mes nesh kishte edhe të dëlirë, dhe po prej nesh kishte edhe të tjerë. Ishim të ndarë në sekte të ndryshme.

وَإِنَّا مِنَّا الصَّالِحُونَ وَمِمَّا دُونَ ذَلِكَ ۖ كُنَّا طَرَائِقَ قَدَدًا ۝٤

13. Dhe ne besonim (edhe më parë) që kurrë nuk mund ta mundim dot Allahun në tokë, dhe as nuk mund ta mundim dot duke ikur.

وَإِنَّا ظَنَيْنَا أَنْ لَنْ نُوعِزَ اللَّهُ فِي الْأَرْضِ وَلَنْ نُوعِزَهُ هَرَبًا ۝٥

14. Dhe ne kur e dëgjuam udhëzimin, e besuam. Pra, kushdo që beson në Zotin e tij, nuk do të ketë frikë as për ndonjë humbje, e as për ndonjë padrejtësi.

وَإِنَّا لَمَّا سَمِعْنَا الْهُدَىٰ آمَنَّا بِهِ ۖ فَمَنْ يُؤْمِنُ بِرَبِّهِ فَلَا يَحَافُفُ بَخْسًا وَوَلَا رَهَقًا ۝٦

2. Dy gjëra kanë nevojë të sqarohen në ajetet 2-10. Xhindët që erdhën tek Profeti Muhammed<sup>savs</sup>, nuk ishin xhindë të mbinatyrshëm që përliten zakonisht, por ishin prijës të një populli njerëzish. Hadithet sqarojnë se ata gatuan ushqimin e tyre, ndezën zjarr dhe se sahabët më vonë panë edhe prush të shuar që ata kishin lënë pas. Mendohet se ata ishin delegatë të një fisi të Bijve të Izraelit që jetonin në Afganistan. Kur e dëgjuan lajmin e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, ata erdhën vetë për ta vërtetuar. Pas diskutimeve të gjata, ata jo vetëm që e pranuan me zemër të sinqertë Profetin<sup>savs</sup>, madje rrëzuan edhe besimin e gabuar që disa njerëz të tyre mendjelehtë e kishin se gjoja Allahu nuk do të dërgonte më ndonjë Profet në botë. Pas kësaj, ata u kthyen te populli i tyre, ua dhanë mesazhin dhe i bënë muslimanë edhe ata.

15. Dhe mes nesh kishte edhe të nënshtruar, dhe po prej nesh kishte edhe të padrejtë.” Pra, pikërisht ata që u nënshtruan, kërkuan udhëzimin.

وَأَنَا مِنَ الْمُسْلِمُونَ وَمِنَّا الْقَاسِطُونَ ۖ فَمَنْ  
أَسْلَمَ فَأُولَئِكَ تَحَرَّوْا رَشَدًا ﴿١٥﴾

16. Kurse të padrejtët u bënë lëndë djegëse e xhehenemit.

وَأَمَّا الْقَاسِطُونَ فَكَانُوا لِجَهَنَّمَ حَطَبًا ﴿١٦﴾

17. Po të kishin qenë të qëndrueshëm në drejtimin e saktë, Ne do t'i furnizonim me ujë të bollshëm.

وَ أَنْ لَوْ اسْتَقَامُوا عَلَى الطَّرِيقَةِ  
لَأَسْقَيْنَهُمْ مَاءً غَدَقًا ﴿١٧﴾

18. Që t'i sprovonim përmes tij. Dhe ai që u shmang nga përkujtimi i Zotit të tij, (Zoti) do ta drejtojë atë në një ndëshkim që shtohet.

لِنُقَبِّضَهُمْ فِيهِ ۖ وَمَنْ يُعْرِضْ عَنْ ذِكْرِ رَبِّهِ  
يَسْلُكْهُ عَذَابًا صَعَدًا ﴿١٨﴾

19. Dhe, sigurisht, xhamitë janë për Allahun, andaj, mos lusni tjetërkënd bashkë me Allahun.

وَ أَنَّ الْمَسْجِدَ لِلَّهِ فَلَا تَدْعُوا مَعَ اللَّهِ  
أَحَدًا ﴿١٩﴾

20. Dhe se kur robi i Allahut ngrihet duke iu lutur Atij, ata bëhen gati t'i vërsulen duke bërë potere.<sup>3</sup>

وَ أَنَّهُ لَمَّا قَامَ عَبْدُ اللَّهِ يَدْعُوهُ كَادُوا  
يَكْفُرُونَ عَلَيْهِ لِبَدًا ﴿٢٠﴾

21. Thuaj: Unë i lutem vetëm Zotit tim dhe nuk bëj dikë ortak me Të.

قُلْ إِنَّمَا أَدْعُوا رَبِّي وَلَا أُشْرِكُ بِهِ أَحَدًا ﴿٢١﴾

22. Thuaj: Unë nuk kam fuqi t'ju sjell as dëm e as mirësi.

قُلْ إِنِّي لَا أَمْلِكُ لَكُمْ ضَرًّا وَلَا رَشَدًا ﴿٢٢﴾

23. Thuaj: Mua askush nuk mund të më strehojë dot kundër Allahut, dhe unë as nuk mund të gjej dot ndonjë strehë duke e lënë Atë;

قُلْ إِنِّي لَنْ يُجِيرَنِي مِنَ اللَّهِ أَحَدٌ ۚ وَلَنْ  
أَجِدَ مِنْ دُونِهِ مُلْتَحَدًا ﴿٢٣﴾

24. por duke predikuar fjalën e Allahut dhe duke kumtuar mesazhet

إِلَّا بَلَاغًا مِنَ اللَّهِ وَرِسَالَاتِهِ ۗ وَمَنْ يَعْصِ  
اللَّهَ وَرَسُولَهُ فَإِنَّ لَهُ نَارَ جَهَنَّمَ خَالِدًا

3. Për këtë kuptim të fjalës *libede*, shikoni “Mufredat-in” e Imam Ragibit<sup>tr</sup>.

فِيهَا أَبَدًا ۝

e Tij. Dhe ai që kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e tij, për të ka zjarr xhehenemi, në të cilin ai do të jetojë gjatë.

25. E kur ata do ta shohin atë për të cilin janë paralajmëruar, do të mësojnë se kush është më i dobëti si ndihmëtar dhe më i pakti në numër.

حَتَّىٰ إِذَا رَأَوْا مَا يُوعَدُونَ فَيَسْئَلُونَ  
مَنْ أَضْعَفُ نَاصِرًا وَ أَوْ أَقْلُّ عَدَدًا ۝

26. Thuaj: Unë nuk e di nëse ajo që ju paralajmërohet është e afërt, apo Zoti im do ta zgjasë afatin e saj.

قُلْ إِنْ أَدْرِيٓ أَقْرَبُٓ مَا تُوعَدُونَ أَمْ يَجْعَلُ  
لَهُ رَبِّيٓ أَمَدًا ۝

27. Ai është i Dijshmi i së padukshmes, andaj, Ai nuk ia zbulon të padukshmen e Tij askujt,

عِلْمُ الْغَيْبِ فَلَا يُظْهِرُ عَلَىٰ غَيْبِهِ أَحَدًا ۝

28. përveç të Dërguarit që Ai e zgjedh, më pas, para dhe pas tij ecën rojtarë.<sup>4</sup>

إِلَّا مَنِ ارْتَضَىٰ مِنْ رَسُولٍ فَإِنَّهُ يَسْلُكُ  
مِنْ بَيْنِ يَدَيْهِ وَمِنْ خَلْفِهِ رَصَدًا ۝

29. Që Ai të dijë se (të Dërguarit) i kanë përçuar mesazhet e Zotit të tyre. Ai e ka rrethuar gjithçka që kanë ata dhe ka llogaritur çdo gjë një për një.

يَعْلَمَ أَنْ قَدْ أَبْلَغُوا رِسَالَاتِ رَبِّهِمْ  
وَ أَحَاطَ بِمَا لَدَيْهِمْ وَأَحْصَىٰ كُلَّ شَيْءٍ  
عَدَدًا ۝

4. Ajetet 27-28: Zoti u jep vetëm të Dërguarve dhe Profetëve të Tij dijen e së padukshmes në një masë, që të thuash se ata e zotërojnë të padukshmen, qoftë në sasi, qoftë në cilësi. Po, ka edhe prej njerëzve të tjerë që shohin ëndrra të vërteta, ndokush merr edhe shpallje të vërtetë, edhe pse edhe këto nuk janë pa ndonjë grimë të errët, megjithatë, atyre nuk u hapen portat e së padukshmes, siç u hapen vetëm të Dërguarve të Zotit. Në botë ka edhe nga ata që falltojnë dhe bëjnë parashikime. Dallimi mes parashikimeve të tyre dhe mes zbulimit të së padukshmes nga ana e të Dërguarve të Zotit është që këta të fundit sjellin një ndikim dhe fuqi jashtëzakonisht të madhe të Zotit me shpalljet e tyre. Edhe në këtë ajet folja në arabisht është "idh'har", që do të thotë zbulim i fuqishëm dhe madhështor. Në arabisht *profetit* i thonë *nebij*, që do të thotë ai që informohet me shumicë prej Zotit për lajme të së padukshmes dhe më pas ato ua njofton njerëzve. Andaj, çdokush që e plotëson këtë kriter, quhet Profet. Por është kushti për Profetin (*nebij*), që të jetë edhe i Dërguar (*resul*), sepse nëse ai nuk është i dërguar, këto ajete ia ndalojnë marrjen me shumicë të lajmeve të së padukshmes. Për llojet e komunikimit me Zotin, lexoni 42:52.



## Surja 73 – El-Muzzemmil

Surja El-Muzzemmil zbriti në periudhën e hershme mekase dhe, bashkë me *bismillahin*, ka njëzet e një ajete.

Për adhurimin e Profetit Muhammed<sup>savs</sup> ndaj Allahut që ishte përmendur në suren paraardhëse, kjo sure që në fillim të saj jep më shumë detaje, duke thënë se ai çohet gjatë netëve dhe shumicën e kohës e adhuronte Allahun me përgjërime dhe me një sinqeritet të papërshkrueshëm. Për të mundur dëshirat vetjake, kjo sure të udhëzon se nuk ka mjet më të mirë sesa të çohesh gjatë natës dhe, duke e adhuruar Zotin, mund t'i shkelësh me këmbë dëshirat vetjake.

Në këtë sure edhe njëherë tjetër është përmendur ngjashmëria e Profetit Muhammed<sup>savs</sup> me Hazret Musain<sup>as</sup>, se, që të dy janë të Dërguar madhështorë që sollën shariate, pra ligje Hyjnore. Ne e dimë që një nga mbretëritë më të forta të kohës, siç ishte ajo e Faraonit, guxoi t'i kundërvihet Hazret Musait<sup>as</sup>, dhe Allahu e fundosi krejt mbretërinë e tij. Në të njëjtën mënyrë u bëhet paralajmërim edhe atyre që i kundërvihen Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, që Allahu mund t'i fundosë edhe ata në shkatërrim, nëse ata nuk tërhiqen.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithë-mëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. O i mbuluar!

يَا أَيُّهَا الْمُرْمِلُ ①

3. Ngrihu natën, pos pak;

قُمِ اللَّيْلَ إِلَّا قَلِيلًا ①

4. a gjysmën e saj, ose pakëso një pjesë të vogël (edhe) nga ajo;

نُصِفَهُ أَوْ انْقُصْ مِنْهُ قَلِيلًا ①

5. ose shtoje më tepër se ajo; dhe recito me ritëm Kuranin.

أَوْزِدْ عَلَيْهِ وَرَتِّلِ الْقُرْآنَ تَرْتِيلًا ①

6. Pa dyshim, Ne do të zbresim mbi ty një fjalë me shumë peshë.

إِنَّا سَنُلْقِي عَلَيْكَ قَوْلًا ثَقِيلًا ①

7. Sigurisht, ngritja gjatë natës është (mjeti) më i fortë për të mposhtur me këmbë (nepsin) dhe më i drejtë për të folur.

إِنَّ نَاشِئَةَ اللَّيْلِ هِيَ أَشَدُّ وَطْأً وَأَقْوَمُ قِيلًا ①

8. Gjatë ditës, ti ke angazhime të gjata.

إِنَّ لَكَ فِي النَّهَارِ سَبْحًا طَوِيلًا ①

9. Përmende emrin e Zotit tënd dhe përkushtoj plotësisht Atij.

وَادْكُرِ اسْمَ رَبِّكَ وَتَبَتَّلْ إِلَيْهِ تَبْتِيلًا ①

10. Ai është Zoti i Lindjes dhe i Perëndimit; nuk ka të adhurueshëm tjetër përveç Tij, andaj Atë merre Kujdestar.

رَبُّ الْمَشْرِقِ وَالْمَغْرِبِ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ فَاتَّخِذْهُ وَكِيلًا ①

11. Duro për atë që ata thonë dhe ndahu me ta në mënyrë të denjë.

وَاصْبِرْ عَلَىٰ مَا يَقُولُونَ وَاهْجُرْهُمْ هَجْرًا جَمِيلًا ①

12. Dhe Më lër Mua dhe mohuesit pasanikë; dhe jepu pak afat.

وَدَرْنِي وَالْمُكَذِّبِينَ أُولِي النَّعْمَةِ وَمَهْلَهُمْ  
قَلِيلًا ﴿١٢﴾

13. Sigurisht, Ne kemi pranga e xhehenem;

إِنَّ لَدَيْنَا أَنْكَالًا وَجَحِيمًا ﴿١٣﴾

14. dhe një ushqim që s'kapërdihet e ndëshkim të rëndë.

وَطَعَامًا ذَاغَصَّةٍ وَعَذَابًا أَلِيمًا ﴿١٤﴾

15. Ditën kur do të tronditen fort toka dhe malet, dhe malet do të bëhen kodra rëre të shpërndara.

يَوْمَ تَرْجُفُ الْأَرْضُ وَالجِبَالُ وَكَانَتِ  
الْجِبَالُ كَثِيبًا مَّهِيلًا ﴿١٥﴾

16. Sigurisht, Ne ju dërguam juve një të Dërguar si dëshmitar mbi ju, njësoj siç kishim dërguar një të Dërguar edhe te Faraoni.

إِنَّا أَرْسَلْنَا إِلَيْكُمْ رَسُولًا شَاهِدًا عَلَيْكُمْ  
كَمَا أَرْسَلْنَا إِلَى فِرْعَوْنَ رَسُولًا ﴿١٦﴾

17. Faraoni e kundërshtoi të Dërguarin, atëherë Ne e zumë atë me një kapje të rëndë.

فَعَصَى فِرْعَوْنُ الرَّسُولَ فَأَحَدْنَاهُ أَحَدًا  
وَبِئْسَ مَا كَانَتْ تَرْجِيئًا ﴿١٧﴾

18. Andaj, nëse (edhe) ju mohoni, si do të shpëtoni nga dita e cila fëmijët do t'i kthejë në pleq.

فَكَيْفَ تَتَّقُونَ إِنْ كَفَرْتُمْ يَوْمًا يَجْعَلُ  
الْوَالِدَانَ سِيبًا ﴿١٨﴾

19. Qielli do të çahet prej (Ilahtarisë së) saj. Ky është premtimi i Tij që do të plotësohet pashmangshmërisht.

السَّمَاءِ مُنْفَطِرٍ بِهِ ۗ كَانَ وَعْدُهُ مَفْعُولًا ﴿١٩﴾

20. Sigurisht, kjo është një këshillë. Kush të dojë, le të marrë rrugën drejt Zotit të tij.

إِنَّ هَذِهِ تَذَكُّرَةٌ ۖ فَمَنْ شَاءَ اتَّخَذَ إِلَىٰ رَبِّهِ  
سَبِيلًا ﴿٢٠﴾

21. Pa dyshim, Zoti yt e di që ti qëndron gati dy të tretën e natës, ose gjysmën e saj, ose pjesën e tretë të saj, po kështu dhe një grup prej atyre që janë me ty. Allahu përcakton masën

إِنَّ رَبَّكَ يَعْلَمُ أَنَّكَ تَقُومُ أَدْنَىٰ مِنْ ثُلُثِي  
الَّيْلِ وَنِصْفَهُ وَثُلُثَهُ وَطَآئِفَةٌ مِّنَ الَّذِينَ  
مَعَكَ ۗ وَاللَّهُ يُقَدِّرُ اللَّيْلَ وَالنَّهَارَ ۗ عَلِمَ

e natës dhe të ditës. Ai e di që ju nuk i përmbaheni dot, andaj ju ka falur duke ju treguar mëshirë. Kështu që, lexoni Kuranin aq sa mundeni. Ai e di që disa prej jush do të jenë edhe të sëmurë, disa të tjerë duke udhëtuar në tokë, në kërkim të bekimit të Allahut, dhe disa të tjerë duke luftuar në rrugën e Allahut. Andaj, lexoni prej tij aq sa mundeni. Falni namazin, jepni zekatin dhe jepini Allahut hua të mirë. Çdo të mirë që dërgoni përpara për veten tuaj, do ta gjeni pranë Allahut; ajo do të jetë më e mirë dhe më e madhe si shpërblim. Dhe kërkojini falje Allahut. Sigurisht, Allahu është shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.

أَنْ تَنْ تَحْصُوهُ فَتَابَ عَلَيْكُمْ فَاقْرَءُوا  
 مَا تَيَسَّرَ مِنَ الْقُرْآنِ ۗ عَلِمَ أَنْ سَيَكُونُ  
 مِنْكُمْ مَّرْضَىٰ ۖ وَآخَرُونَ يَضْرِبُونَ فِي  
 الْأَرْضِ يَبْتَغُونَ مِنْ فَضْلِ اللَّهِ ۖ  
 وَآخَرُونَ يُقَاتِلُونَ فِي سَبِيلِ اللَّهِ ۗ  
 فَاقْرَءُوا مَا تَيَسَّرَ مِنْهُ ۗ وَأَقِيمُوا الصَّلَاةَ  
 وَآتُوا الزَّكَاةَ وَاقْرَضُوا اللَّهَ قَرْضًا حَسَنًا ۗ  
 وَمَا تُقَدِّمُوا لِأَنْفُسِكُمْ مِنْ خَيْرٍ تَجِدُوهُ  
 عِنْدَ اللَّهِ هُوَ خَيْرًا ۖ وَأَعْظَمَ أَجْرًا ۗ  
 ۝ وَاسْتَغْفِرُوا لِلَّذِينَ تَبَتُّوا مِنْهُ  
 بِقَوْلٍ مِثْلُ ۝ وَإِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَحِيمٌ ۝

## Surja 74 – El-Muddeththir

Surja El-Muddeththir u zbrit në periudhën e hershme mekase dhe, bashkë me bismil-lahin, ka pesëdhjetë e shtatë ajete.

Sikundër në suren paraardhëse Profeti Muhammed<sup>savs</sup> u quajt i mbuluar (arab. *muzzemmil*), pra ai që e ka mbuluar fort veten e tij me një çarçaf, edhe në këtë sure po vijon e njëjta temë. Në këtë sure ka edhe hollësi që tregojnë se çfarë rrobash (arab. *thijab*) ishin ato që Profeti<sup>savs</sup> i mbante fortë me veten e tij dhe që edhe i pastronte. [Në kontekstin për Profetin Muhammed<sup>savs</sup>], pastrimi i rrobave në këto ajete nuk do të thotë pastrim i rrobave të trupit, por nënkupton pastrimin shpirtëror të sahabëve, të cilët i rrinin afër dhe pastroheshin prej shpirtit të pastër të Profetit<sup>savs</sup>, largoheshin nga papastërtia shpirtërore (arab. *ruxhz*), ndërkohë që shumë prej tyre deri më parë e kishin të pamundur një gjë të tillë.

Veç kësaj, fjala *papastërti* (arab. *ruxhz*), mund të nënkuptojë edhe idhujtarët mekas, prej të cilëve, kjo sure e porositi Profetin<sup>savs</sup> të shmangte tërësisht.

Kjo sure flet për nëntëmbëdhjetë engjëj të ashpër, të cilët nuk do të bëjnë asnjë lëshim për të ndëshkuar fajtorët. Numri nëntëmbëdhjetë është një tregues edhe për ato aftësi të njeriut, keqpërdorimi i të cilave mund ta çojë atë në xhehenem. Zoti i ka dhënë njeriut organe e gjymtyrë të ndryshme, që funksionojnë në trupin dhe shpirtin e tij nga koka gjer në këmbë. Nëse ai i përdor ato denjësisht, mund të shpëtojë nga mëkatet dhe gabimet. Numri i këtyre aftësive të tij ndoshta shkon deri në nëntëmbëdhjetë. Por sado qofshin ato, kjo sure hedh dritë mbi faktin që ushtritë e Allahut janë të pafundme, dhe duke u ndalur te numri nëntëmbëdhjetë, askush nuk duhet të mendojë se aq janë engjëjt e Tij. Në fakt, edhe ata engjëj të Allahut që janë të përcaktuar për ndëshkim, janë të panumërt, të cilët caktohen nga Zoti në bazë të gjendjes së njeriut.

Në këtë sure Zoti i Madhërishëm betohet për një hënë që do të shfaqej pas diellit, duke e ndjekur atë. Edhe kjo është një temë me shumë kuptime, e cila përmendet edhe në suren 91, Esh-Shems.



- |                                                                      |                                         |
|----------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------|
| <p>1. Me emrin e Allahut, të Gjithë-mëshirshmit, Mëshirëbërësit.</p> | بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ① |
| <p>2. O i mbështjellë!</p>                                           | يَا أَيُّهَا الْمُدَّثِّرُ ②            |
| <p>3. Ngrihu dhe alarmo.</p>                                         | قُمْ فَأَنْذِرْ ③                       |
| <p>4. Zotin tënd madhëroje.</p>                                      | وَرَبِّكَ فَكْبِّرْ ④                   |
| <p>5. Rrobat e tua pastroji.</p>                                     | وَثِيَابَكَ فَطَهِّرْ ⑤                 |
| <p>6. Papastërtinë largoje.</p>                                      | وَالرُّجْزَ فَاهْجُرْ ⑥                 |
| <p>7. Mos bëj mirësi për të kërkuar më shumë.</p>                    | وَلَا تَمُنْ بِتَسْكَثِرٍ ⑦             |
| <p>8. Dhe për Zotin tënd duro.</p>                                   | وَلِرَبِّكَ فَاصْبِرْ ⑧                 |
| <p>9. Kur do t'i fryhet borisë,</p>                                  | فَإِذَا نُقِرَ فِي النَّاقُورِ ⑨        |
| <p>10. ajo ditë do të jetë ditë e rëndë.</p>                         | فَذَلِكَ يَوْمَئِذٍ يَوْمٌ عَسِيرٌ ⑩    |
| <p>11. Jo e lehtë për mohuesit.</p>                                  | عَلَى الْكُفْرَيْنَ غَيْرٌ يَسِيرٌ ⑪    |
| <p>12. Na lër vetëm Mua dhe atë që kam krijuar.</p>                  | ذُرِّيٍّ وَمَنْ خَلَقْتُ وَجِيدًا ⑫     |
| <p>13. Atij i bëra pasuri të bollshme,</p>                           | وَجَعَلْتُ لَهُ مَالًا مَمْدُودًا ⑬     |
| <p>14. dhe djem që rrinin para syve.</p>                             | وَبَنِينَ شُهُودًا ⑭                    |
| <p>15. I përgatita (çdo gjë) të nevojshme.</p>                       | وَمَهَّدْتُ لَهُ تَمْهِيدًا ⑮           |
| <p>16. Sërish, ai lakmon t'i jap më shumë.</p>                       | ثُمَّ يَطْمَعُ أَنْ أَزِيدَ ⑯           |

17. Kursesesi! Ai ka qenë armik i shenjave Tona.

كَلَّا إِنَّهُ كَانَ لِآيَاتِنَا عَنِيدًا ﴿١٧﴾

18. Unë patjetër do t'i ngarkoj atij një vështirësi që vetëm i rëndohet.

سَأَرْهُقُهُ صِعُودًا ﴿١٨﴾

19. Sigurisht, ai u mendua dhe i bëri llogaritë.

إِنَّهُ فَكَّرَ وَقَدَّرَ ﴿١٩﴾

20. U shkatërroftë për llogaritë që bëri!

فَقَتِلَ كَيْفَ قَدَّرَ ﴿٢٠﴾

21. Sërish, u shkatërroftë për llogaritë që bëri!

ثُمَّ قُتِلَ كَيْفَ قَدَّرَ ﴿٢١﴾

22. Pastaj vështroi.

ثُمَّ نَظَرَ ﴿٢٢﴾

23. Pastaj ngërtheu vetullat dhe u vrenjt.

ثُمَّ عَبَسَ وَبَسَرَ ﴿٢٣﴾

24. Pastaj e ktheu shpinën dhe u tregua mendjemadh.

ثُمَّ أَدْبَرَ وَاسْتَكْبَرَ ﴿٢٤﴾

25. Dhe tha: "Kjo është vetëm një magji e praktikuar;

فَقَالَ إِنَّ هَذَا إِلَّا سِحْرٌ يُؤْتَرُ ﴿٢٥﴾

26. kjo është vetëm fjalë njeriu!"

إِنَّ هَذَا إِلَّا قَوْلُ الْبَشَرِ ﴿٢٦﴾

27. Unë përnjëmend do ta hedh në *seker*.

سَأَصْلِيهِ سَقَرًا ﴿٢٧﴾

28. E si mund ta dish ti se çfarë është *sekeri*?

وَمَا أَدْرَاكَ مَا سَقَرٌ ﴿٢٨﴾

29. Ai as nuk lë gjë të mbetet, e as nuk hiqet.

لَا يُبْقِي وَلَا تَذَرُ ﴿٢٩﴾

30. E zhurit faqen.

لَوَّاحَةٌ لِلْبَشَرِ ﴿٣٠﴾

31. Mbi të qëndrojnë nëntëmbëdhjetë (rojtare).

عَلَيْهَا تِسْعَةَ عَشَرَ ﴿٣١﴾

32. Dhe Ne nuk i bëmë rojtare të xhehenemit përveç engjëjve. Nuk e caktuam as numrin e tyre, përveçse si sprovë për ata që mohuan; që të binden ata të cilëve u është dhënë Libri; që t'u shtohet besimi atyre që besuan; që të mos mbeten në dyshim ata të cilëve u është dhënë Libri si dhe besimtarët; dhe që ata të cilët kanë "sëmundje" në zemër si dhe mohuesit, të thonë: "Çfarë deshi Allahu me këtë shembull?". Kështu Allahu e cilëson të devijuar kë të dojë dhe udhëzon kë të dojë. Askush nuk i di ushtritë e Zotit tënd përveç Atij. Dhe kjo nuk është asgjë tjetër por vetëm këshillë për njeriun.

وَمَا جَعَلْنَا أَصْحَابَ النَّارِ إِلَّا مَلَائِكَةً  
وَمَا جَعَلْنَا عِدَّتَهُمْ إِلَّا فِتْنَةً لِلَّذِينَ  
كَفَرُوا لِيَسْتَيْقِنَ الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ  
وَيَزِدَّادَ الَّذِينَ آمَنُوا إِيمَانًا وَلَا يَرْتَابَ  
الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ وَالْمُؤْمِنُونَ ۗ وَلِيَقُولَ  
الَّذِينَ فِي قُلُوبِهِمْ مَرَضٌ وَالْكَافِرُونَ  
مَاذَا أَرَادَ اللَّهُ بِهَذَا مَثَلًا ۗ كَذَلِكَ يُضِلُّ  
اللَّهُ مَن يَشَاءُ وَيَهْدِي مَن يَشَاءُ ۗ وَمَا  
يَعْلَمُ جُنُودَ رَبِّكَ إِلَّا هُوَ ۗ وَمَا هِيَ إِلَّا  
﴿٣٢﴾ ذِكْرِي لِلْبَشَرِ ﴿٣٢﴾

33. Dëgjoni! Beto hem për hënën!

كَلَّا وَالْقَمَرِ ﴿٣٣﴾

34. Dhe për natën kur largohet!

وَاللَّيْلِ إِذَا أَدْبَرَ ﴿٣٤﴾

35. Dhe për mëngjesin kur zbardhet!

وَالصُّبْحِ إِذَا أَسْفَرَ ﴿٣٥﴾

36. Se, pa dyshim, kjo është një nga gjërat e mëdha.

إِنَّهَا لِأَحَدَى الْكَبْرِ ﴿٣٦﴾

37. Alarmuese për njeriun.

نَذِيرًا لِلْبَشَرِ ﴿٣٧﴾

38. Që kushdo prej jush të ecë përpara ose të mbetet mbrapa.

لِمَن شَاءَ مِنْكُمْ أَنْ يَتَقَدَّمَ أَوْ يَتَأَخَّرَ ﴿٣٨﴾

39. Çdo shpirt është peng i asaj që ka punuar,

كُلُّ نَفْسٍ بِمَا كَسَبَتْ رَهِينَةٌ ﴿٣٩﴾

40. përveç njerëzve të së djathtës.

إِلَّا أَصْحَابَ الْيَمِينِ ﴿٤٠﴾



41. Ata do të jenë në xhenete. Do të pyesin njëri-tjetrin

﴿ فِي جَنَّتٍ يُتَسَاءَلُونَ ﴾<sup>٤١</sup>

42. rreth faktorëve.

﴿ عَنِ الْمُجْرِمِينَ ﴾<sup>٤٢</sup>

43. “Çfarë ju pruri në *seker*”, (pra në xhehenem)?<sup>1</sup>

﴿ مَا سَأَلَكُمْ فِي سَقَرٍ ﴾<sup>٤٣</sup>

44. Ata do të thonë: “Ne nuk ishim nga ata që faleshin,

﴿ قَالُوا لَمْ نَكُ مِنَ الْمَصْلِينَ ﴾<sup>٤٤</sup>

45. nuk i ushqenim nevojtarët,

﴿ وَلَمْ نَكُ نَطْعُمُ الْمَسْكِينِ ﴾<sup>٤٥</sup>

46. angazhoheshim në kotësi, bashkë me ata që bënin gjëra të kota,

﴿ وَكُنَّا نَحْوُصُّ مَعَ الْخَائِضِينَ ﴾<sup>٤٦</sup>

47. dhe e quanim gënjeshtër Ditën e Gjykimit.

﴿ وَكُنَّا نُكَذِّبُ بِيَوْمِ الدِّينِ ﴾<sup>٤٧</sup>

48. Gjersa na erdhi vdekja.”

﴿ حَتَّىٰ آتَانَا الْيَقِينَ ﴾<sup>٤٨</sup>

49. Atëherë nuk do t'i shpëtojë dot ndërmjetësimi i ndërmjetësuesve.

﴿ فَمَا تَنْفَعُهُمْ شَفَاعَةُ الشَّافِعِينَ ﴾<sup>٤٩</sup>

50. E çfarë u kishte ndodhur që i shmangeshin këshillës!

﴿ فَمَا لَهُمْ عَنِ التَّذْكَرَةِ مُعْرِضِينَ ﴾<sup>٥٠</sup>

51. Sikur të ishin gomerë të frikësuar

﴿ كَأَنَّهُمْ حُمُرٌ مُّسْتَنْفِرَةٌ ﴾<sup>٥١</sup>

52. (që) ikin prej luanit.

﴿ فَرَّتْ مِنْ قَسْوَرَةٍ ﴾<sup>٥٢</sup>

53. Por çdokush prej tyre dëshironte që t'i jepeshin skripte të përhapura (të pikëpamjes së tij).<sup>2</sup>

﴿ بَلْ يُرِيدُ كُلُّ امْرِئٍ مِّنْهُمْ أَنْ يُؤْتَىٰ صُحُفًا مُّنَشَّرَةً ﴾<sup>٥٣</sup>

54. Kujdes! Ata nuk i frikësoheshin *ahiretit*.

﴿ كَلَّا بَلْ لَا يَخَافُونَ الْآخِرَةَ ﴾<sup>٥٤</sup>

1. Për *sekerin*, lexoni 74:27-31.

2. Kuptime të këtij ajeti lidhen me ajetin “*Kur librat do të shpërndahen!*” (Et-Tekvir 81:11).

55. Kujdes! Kjo është një këshillë.

كَلَّا إِنَّهُ تَذَكَّرٌ ﴿٥٥﴾

56. Kush të dojë, le ta mbajë në kujtesë.

فَمَنْ شَاءَ ذَكَرْهُ ﴿٥٦﴾

57. Ata nuk do ta kujtojnë këshillën, përveçse nëse do Allahu. Vetëm Ai është i denjë që (njeriu) të ketë druajtje (ndaj Tij) dhe vetëm Ai është i denjë për të falur.

وَمَا يَذْكُرُونَ إِلَّا أَنْ يَشَاءَ اللَّهُ ۗ هُوَ أَهْلٌ  
بِالسَّمَوَاتِ وَآهْلِ الْمَغْفِرَةِ ﴿٥٧﴾

## Surja 75 – El-Kijame

Surja El-Kijame është zbritur në periudhën e hershme mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka dyzet e një ajete.

Surja paraardhëse tregon që një nga arsyet se pse disa njerëz përfundojnë në xhehenem është mohimi ndaj Ditës së Gjykimit. Realisht, një prej shkaqeve kryesore të shumicës së mëkateve të njeriut është pikërisht mohimi i tij për botën e përtejme. Kjo shkakton edhe çrregullim të madh në të gjithë botën. Kështu, që në fillim të kësaj sureje, betohet për Ditën e Kiametit, dhe për shpirtin që vazhdimisht e qorton njeriun, sepse nëse njeriu përfiton nga kjo gjendje e tij shpirtërore, mund të shpëtojë nga mijëra mëkate.

Një nga arsyet që mohuesit japin për mohimin e kiametit është se kur gjymtyrët e trupit të tyre do të bëhen pluhur dhe do të shpërndahen, si mundet që Allahu t'i mbledhë ato edhe një herë. Por kjo është vetëm shkurtëpamësia e tyre, sepse Kurani i Shenjtë vazhdimisht ka thënë se Zoti do t'i mbledhë jo trupat e tyre tokësorë, por shpirtërorë. Megjithatë, kundërshtari i Zotit e insiston mohimin e tij në mënyrë që të tallet me të Dërguarin e kohës dhe të japë, me demek, një arsytim logjik të mohimit ndaj ahiretit.

*“Kur të verbohët shikimi! Dhe të eklipsohet hëna! Dhe dielli dhe hëna të bashkohen!”*. Këto ajete flasin për çështje që nuk lidhen me Kiametin e madh. Këto janë vetëm shenja të afrimit të atij Kiameti, dhe jo ngjarjet e tij. Kjo sepse kiameti nënkupton prishjen e sistemit të botës në përmasa apokaliptike, kur njeriu nuk do të jetë në gjendje të shohë as eklipsin e hënës, as lëvizjet e diellit, as lëvizjet e hënës.

“Kur të verbohët shikimi!” nënkupton që në atë kohë bota do të pësojë ndëshkime të llahtarshme.

Më pas kjo që tha se njeriu atë ditë nuk do të ketë rrugëdalje, tregon që shenjat e eklipseve të diellit dhe të hënës do të shfaqen si provë e vërtetësisë së një njeriu të premtuar të Zotit, në mënyrë që kundërshtarët të mos kenë asnjë argument për ta mohuar atë. Se kur do të ndodhë bashkimi i eklipseve të diellit dhe të hënës, këtë na e shpjegon vetë Profeti Muhammed<sup>savs</sup> që kjo do të ndodhte në kohën e Imam Mehdiut, për të manifestuar vërtetësinë e tij. Dhe kjo ngjarje tashmë ka ndodhur. Edhe *Hazret Mesihu*, pra Jezusi<sup>as</sup>, kishte bërë një profeci të ngjashme për këtë.

Pas kësaj, kjo sure përmend edhe një mrekulli tjetër të Profetit Muhammed<sup>savs</sup>. Kurani i Shenjtë do të zbritet përgjatë njëzet e tri vitesh, dhe në fillimet e kësaj periudhe, kur ende po shpallehin suret e para të Kuranit, Profeti<sup>savs</sup> i përsëriste me nxitim fjalët Hyjnore, nga frika se mos do t'i harronte më vonë. Por, Allahu i Madhërishtëm i siguron duke thënë – Ne e zbresim Kuranin, dhe po Ne jemi të Plotfuqishëm për ta ruajtur atë. Parafytyroni sesi ky Kuran i zbritur përgjatë njëzet e tri viteve mbi një njeri që nuk dinte shkrim e këndim, u mblodh dhe u ruajt i tëri! *Hazret*

Imam Mehdiu<sup>as</sup> këtë e quan një mrekulli madhështore, sepse gjatë kësaj periudhe, armiku vazhdimisht e sulmoi Profetin Muhammed<sup>savs</sup> dhe nuk la gur pa lëvizur për ta asgjësuar atë dhe misionin e tij të shenjtë. Pas zbritjes së një pjese të Kuranit, nëse armiku do arrinte sukses në përpjekjen e tij për ta asgjësuar Profetin<sup>savs</sup>, kjo profeci për ruajtjen dhe mbledhjen e Kuranit do të mbetej e paplotësuar, dhe si e tillë, *ma'adhallah*, do të provonte pavërtetësinë e Kuranit si një Libër të Zotit. Andaj, profecia në fjalë ishte shumë e madhe.

Më pas, duke treguar fazat e jetës së njeriut përpara lindjes së tij, Zoti i Madhërishëm në këtë sure pohon që njeriu vazhdimisht është në një rrugë drejt zhvillimit të tij. Andaj, si mundet që ai përfundimisht të mos paraqitet përpara Allahut të Madhërishëm për t'i dhënë llogari të veprave të tij?!



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Beto hem për Ditën e Kiametit!

لَا أُقْسِمُ بِيَوْمِ الْقِيَامَةِ ①

3. Dhe betohem për shpirtin që qorton fort!<sup>1</sup>

وَلَا أُقْسِمُ بِالنَّفْسِ اللَّوَّامَةِ ②

4. A mendon njeriu se Ne nuk do t'ia mbledhim eshtrat?!

أَيَحْسَبُ الْإِنْسَانُ أَنْ نَجْمَعَ عِظَامَهُ ③

5. Përkundrazi! Jemi të Plotfuqishëm që t'ia rregullojmë (edhe) majat e gishtave.

بَلَىٰ قَدِيرِينَ عَلَىٰ أَنْ نُسَوِّيَ بَنَانَهُ ④

6. Por njeriu dëshiron të mëkatojë (edhe) në të ardhmen e tij.

بَلَىٰ يُرِيدُ الْإِنْسَانُ لِيَفْجُرَ أَمَامَهُ ⑤

7. Ai pyet: “Kur do të bëhet Dita e Kiametit?”

يَسْأَلُ أَيَّانَ يَوْمِ الْقِيَامَةِ ⑥

1. Burimin e dytë, nga i cili burojnë gjendjet morale, Kurani e quan *shpirt qortues (nفسun levvameh)*, siç e thotë në këtë ajet. Ky shpirt është burimi i dytë i gjendjeve të njeriut që i vë në lëvizje gjendjet morale dhe njeriun e dallon nga shtazët. Në këtë ajet, betimi në emër të këtij shpirti është bërë për ta nderuar atë, sepse ai ka kaluar nga shpirti *emmareh* (që urdhëron fort për të keqen) duke e përvetësuar atë *levvameh* (që qorton për mëkatën që ka bërë), gjë që i dha nder përpara Zotit. Ky shpirt u quajt *levvameh*, sepse ai e qorton njeriun për veprat e këqija dhe nuk pajtohet me të nëse ai kalon një jetë të shfrenuar si kafshët. Madje, ai dëshiron që njeriu të realizojë sjellje e morale të mira e të mos humbë ekuilibrin në të gjitha parimet e jetës dhe që emocionet e dëshirat instinktive t'i realizojë duke u këshilluar me mendjen. Ky shpirt, ngaqë e qorton njeriun për të keqen, quhet *levvameh*, që do të thotë qortues i rreptë. Por, shpirti *levvameh*, edhe pse nuk i pëlqen impulset instinktive, madje e qorton njeriun për to, prapë nuk mund të jetë i aftë në mënyrë të plotë për të bërë veprat e mira, sepse ndonjëherë u nënshtrohet impulseve instinktive, dhe si rrjedhojë gremiset e rrëzohet si një fëmijë, i cili edhe pse nuk dëshiron, rrëzohet për shkak të pafuqisë, madje edhe pendohet për dobësinë e tij. Pra, kjo është ajo gjendje morale, kur shpirti fillon të mbledhë në veten e tij virtytet e larta dhe dëshiron ta mposhtë mosbindjen, megjithëse nuk e mbizotëron atë krejtësisht. (Për *nفسun emmareh*, lexoni 12:54).

8. Atëherë, kur të verbohët shikimi; فَإِذَا بَرِقَ الْبَصَرُ ۝٨
9. kur të eklipsohet hëna; وَخَسَفَ الْقَمَرُ ۝٩
10. dhe kur të bashkohen dielli e hëna. وَجُمِعَ الشَّمْسُ وَالْقَمَرُ ۝١٠
11. Atë ditë njeriu do të thotë: “Ku të iki për shpëtim!” يَقُولُ الْإِنْسَانُ يَوْمَئِذٍ أَيَّنَ الْمَفْرُجِ ۝١١
12. Jo, dëgjoni! Nuk ka vendshpëtim! كَلَّا لَا وَزَرَ ۝١٢
13. Atë ditë veç te Zoti yt do të jetë vend qetësie. إِلَىٰ رَبِّكَ يَوْمَئِذٍ الْمُسْتَقَرُّ ۝١٣
14. Njeriu do të njoftohet atë ditë për çfarë ka dërguar përpara dhe çfarë ka lënë pas. يَتَّبِعُوا الْإِنْسَانُ يَوْمَئِذٍ بِمَا قَدَّمَ وَأَخَّرَ ۝١٤
15. E vërteta është që njeriu është shumë i vetëdijshëm për veten e tij. بَلِ الْإِنْسَانُ عَلَىٰ نَفْسِهِ بَصِيرَةٌ ۝١٥
16. sado justifikime të japë. وَلَوْ أَلْفَىٰ مَعَاذِيرَهُ ۝١٦
17. Mos lëviz gjuhën tënde gjatë (leximit të) tij (pra, të Kuranit)<sup>2</sup> për ta mbajtur atë përmendsh me nxitim. لَا تَحْرُكْ بِهِ لِسَانَكَ لِتَعْجَلَ بِهِ ۝١٧
18. Sigurisht, është përgjegjësia Jonë edhe mbledhja e tij, edhe leximi i tij.<sup>3</sup> إِنَّ عَلَيْنَا جَمْعَهُ وَقُرْآنَهُ ۝١٨
19. Ndaj, kur Ne ta lexojmë, ti ndiqe leximin e tij. فَإِذَا قَرَأَهُ فَأَتَّبِعْ قُرْآنَهُ ۝١٩

2. Ajeti i drejtohet Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, dhe bëhet fjalë për leximin a recitimin e fjalëve të Kuranit të Shenjtë.

3. Lexoni 15:10.

20. Më pas po mbi Ne është edhe ligjërimi tij.<sup>4</sup>

ثُمَّ إِنَّ عَلَيْنَا بَيَانَهُ ۝

21. Dëgjoni! Ju e dashuroni botën,<sup>5</sup>

كَأَلَّا بَلَّ مُجِبُونَ الْعَاجِلَةَ ۝

22. dhe e lini ahiretin.

وَتَذَرُونَ الْآخِرَةَ ۝

23. Atë ditë disa fytyra do të jenë të freskëta,

وَجُوهٌ يَوْمَئِذٍ نَّاصِرَةٌ ۝

24. duke pasur shikimin te Zoti i tyre.

إِلَىٰ رَبِّهَا نَاظِرَةٌ ۝

25. Dhe atë ditë disa fytyra do të jenë të zymta.

وَوُجُوهٌ يَوْمَئِذٍ بَاسِرَةٌ ۝

26. Ata do të dinë se do t'u këputet kurrizi.

تَظُنُّ أَنْ يُفْعَلَ بِهَا فَاقِرَةٌ ۝

27. Dëgjoni! Kur shpirti do të vijë deri në fyt.

كَلَّا إِذَا بَلَغَتِ التَّرَاقِيَ ۝

28. Dhe do të thuhet: “A ka ndokush që shëron me të fryrë?”

وَقِيلَ مَنْ رَاقٍ ۝

29. Dhe (njeriu) do të besojë se erdhi ndarja.

وَوَظَنَّ أَنَّهٗ الْفِرَاقُ ۝

30. Dhe kur do ta mbulojë pulpa pulpën.

وَالتَّقَّتِ السَّاقُ بِالسَّاقِ ۝

31. Atë ditë drejt Zotit tënd do të jetë shtytja.

عَلَىٰ إِلَىٰ رَبِّكَ يَوْمَئِذٍ الْمَسَاقُ ۝

32. Pra, ai as nuk pranoi të vërtetën, e as nuk u fal,

فَلَا صَدَّقَ وَلَا صَلَّىٰ ۝

4. Lexoni 15:10.

5. Këtu fjala arabe është *el-axhile* (e shpejta), dhe një kuptim i saj është kjo botë ose dynja. (Shikoni fjalorin El-Munxhid).

33. përkundrazi, mohoi dhe ia ktheu shpinën.

وَلَكِنْ كَذَّبَ وَتَوَلَّى ﴿٣٣﴾

34. Më pas shkoi i mburrur te familja.

ثُمَّ ذَهَبَ إِلَىٰ أَهْلِهِ يَمْتَطِي ﴿٣٤﴾

35. Mjerë për ty, mjerë!

أَوْلَىٰ لَكَ فَأَوْلَىٰ ﴿٣٥﴾

36. Sërish, mjerë për ty, mjerë!

ثُمَّ أَوْلَىٰ لَكَ فَأَوْلَىٰ ﴿٣٦﴾

37. A mendon njeriu se do të lihet i lirë?!

أَيَحْسَبُ الْإِنْسَانُ أَنْ يُتْرَكَ سُدًى ﴿٣٧﴾

38. A nuk ishte ai thjesht një pikë sperme që u hodh?!

أَلَمْ يَكْ نُطْفَةً مِنْ مَّيِّ يُمْنَىٰ ﴿٣٨﴾

39. Më pas u bë ngjizje gjaku, e atëherë (Zoti) e krijoi dhe e përsosi.

ثُمَّ كَانَ عَلَقَةً فَخَلَقَ فَسَوَّىٰ ﴿٣٩﴾

40. Më pas prej tij bëri çiftin, mashkullin dhe femrën.

فَجَعَلَ مِنْهُ الرُّؤُوبَيْنِ الذَّكَرَ وَالْأُنثَىٰ ﴿٤٠﴾

41. Po Ai, a nuk është i Plotfuqishëm të ringjallë të vdekurit?!

يَعْلَمُ الْغَيْبَاتِ بِرُؤُوسِ السُّبُحِ أَلَيْسَ ذَلِكَ بِقَدِيرٍ عَلَىٰ أَنْ يَحْيِيَ الْمَوْتَىٰ ﴿٤١﴾



## Surja 76 – Ed-Dehr

Surja Ed-Dehr është zbritur në periudhën e hershme mekase dhe, bashkë me *bismillahin*, ka tridhjetë e dy ajete.

Në këtë sure, Zoti i Madhërishëm i tërheq vëmendjen njeriut për fillimin e tij duke thënë se ai kaloi në një periudhë, kur ishte diçka që nuk vlente për t'u përmendur. Ndërkohë, njeriu që kur ka ardhur në këtë botë, ishte dhe vijon të jetë krijesa më e përmendur. Andaj, këto ajete flasin edhe për atë periudhë të njeriut, kur gjatë evolucionit ai me të vërtetë nuk mund të përmendej. Duket se kjo periudhë i përket asaj kohe kur edhe zogjtë nuk cicëronin, dhe një heshtje e plotë mbretëronte tokën. Prej asaj periudhe ka ardhur njeriu. Vetëm më pas atij iu dhuruan aftësitë e të dëgjuarit dhe të parit. Andaj, Ai Zot që një grusht dheu e bëri të dëgjojë e të shikojë, patjetër që është i Plotfuqishëm ta ringjallë atë për t'i kërkuar llogari edhe për dëgjimin, edhe për shikimin e tij.

Më pas, kjo sure përmend disa veti të veçanta të banorëve të Xhenetit që ata u bëjnë mirësi të tjerëve, jo për të shtuar pasuritë e veta në këmbim, përkundrazi, besojnë dhe pohojnë: Nuk duam asnjë falënderim për këto, dhe duam vetëm pëlqimin e Zotit.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. A nuk kaloi njeriu një periudhë të kohës, kur ai nuk ishte diçka për t'u përmendur?!<sup>1</sup>

هَلْ آتَى عَلَى الْإِنْسَانِ حِينٌ مِّنَ الدَّهْرِ لَمْ يَكُنْ شَيْئًا مَّذْكُورًا ①

3. Sigurisht, Ne e krijuam njeriun prej sperme të përbërë, (që) Ne ta sprovovjmë atë. Ndaj e bëmë dëgjues (dhe) shikues.

إِنَّا خَلَقْنَا الْإِنْسَانَ مِنْ نُطْفَةٍ أَمْشَاجٍ نَّبْتَلِيهِ ①  
فَجَعَلْنَاهُ سَمِيعًا بَصِيرًا ①

4. Ne e drejtuam në udhë; le të jetë mirënjohës ose mosmirënjohës.

إِنَّا هَدَيْنَاهُ السَّبِيلَ إِمَّا شَاكِرًا وَإِمَّا كَفُورًا ①

5. Për mosmirënjohësit Ne kemi përgatitur një sërë zinxhirësh e prangash dhe zjarr flakërues.<sup>2</sup>

إِنَّا آَعْتَدْنَا لِلْكَافِرِينَ سَلَاسِلًا وَأَغْلَالًا وَ سَعِيرًا ①

6. Mirëbërësit do të pinë nga një kupë, që do të jetë e përzier me kamfur.

إِنَّ الْأَبْرَارَ يَشْرَبُونَ مِنْ كَأْسٍ كَانَ مِزَاجُهَا كَافُورًا ①

1. Vërehet se ky ajet flet për epokën para Profetit Adem<sup>as</sup> Lexoni parathënien e sures dhe 7:12.

2. Mohuesve, pra atyre që nuk duan ta pranojnë të vërtetën, Ne u kemi përgatitur *zinxhirë*, *pranga* që u hidhen nëpër qafë, dhe një *zjarr* flakërues. Kuptimi i këtij ajeti është që ata që nuk e kërkojnë Zotin me zemër të sinqertë, vuajnë nga një reaktion i rëndë. Ata përfshihen thellë në botën materiale, sikur të jenë të lidhur pas saj me zinxhirë nëpër këmbë dhe përkulen kaq poshtë në punët tokësore, sikur të kenë pranga nëpër qafë që nuk i lejojnë të ngrenë kokën drejt qiellit. Po kështu, në zemër ata kanë një zjarr lakmie dhe dëshirash, që i nxit të arrijnë këtë sasi parash, të fitojnë këtë pasuri, të pushtojnë këtë shtet, të mundin këtë armik, të kenë kaq shumë para dhe kaq shumë pasuri etj.. Zoti kur i sheh të padenjë dhe tërësisht të zënë në punët e këqija, ua ngjit këto tri gjëma. Këto ajete gjithashtu tregojnë se kur njeriu bën një vepër të caktuar, në përputhje me këtë, edhe Zoti bën një vepër. Për shembull, kur njeriu vepron duke mbyllur të gjitha dritaret e dhomës, karshi kësaj veprë të tij, bëhet vepra e Zotit që ia errëson dhomën. Sepse gjërat, në cilat në ligjin e natyrës, janë bërë si rezultate të pandryshueshme të veprimeve tona të caktuara, në fakt janë veprat e Zotit, sepse pikërisht Ai është Shkaku i të gjitha shkaqeve. I njëjtë është ligji edhe për botën e besimit.

7. Një burim, prej të cilit do të pinë robërit e Allahut dhe të cilin ata do ta zgjerojnë duke e hapur.

عَيْنًا يَشْرَبُ بِهَا عِبَادُ اللَّهِ يُفَجِّرُونَهَا  
تَفْجِيرًا ﴿٧﴾

8. Ata e plotësojnë zotimin dhe frikësohen nga dita, e keqja e së cilës do të përhapet gjerësisht.

يُوفُونَ بِالَّذِذِّ وَيَخَافُونَ يَوْمًا كَانَ شَرُّهُ  
مُسْتَطِيرًا ﴿٨﴾

9. Ata u japin ushqimin, pavarësisht nga dëshira ndaj tij, nevojtarëve, jetimëve dhe të burgosurve.

وَيُطْعِمُونَ الطَّعَامَ عَلَىٰ حَيْثُ مَسَكِينًا وَ  
يَتِيمًا وَ أَسِيرًا ﴿٩﴾

10. “Ne ju ushqejmë vetëm për pëlqimin e Allahut; nuk kërkojmë prej jush as shpërblim e as falënderim.

إِنَّمَا نُطْعِمُكُمْ لِوَجْهِ اللَّهِ لَا نُرِيدُ مِنْكُمْ  
جَزَاءً وَلَا شُكْرًا ﴿١٠﴾

11. Njëmend, ne frikësohemi nga një ditë e rëndë dhe e kobshme (që do të vijë) prej Zotit tonë.”

إِنَّا نَخَافُ مِنْ رَبِّنَا يَوْمًا عَبُوسًا  
قَمْطَرِيرًا ﴿١١﴾

12. Andaj, Allahu i shpëtoi nga e keqja e asaj dite, dhe u dha freski e kënaqësi.

فَوَقَّاهُمُ اللَّهُ شَرَّ ذَلِكَ الْيَوْمِ وَلَقَّاهُمْ نَضْرَةً  
وَسُرُورًا ﴿١٢﴾

13. Dhe për shkak se duruan, i shpërbleu me një xhenet dhe një mëndafsh.

وَ جَزَاهُمْ بِمَا صَبَرُوا جَنَّةً وَ حَرِيرًا ﴿١٣﴾

14. Në të ata do të jenë mbështetur nëpër frone të zbukuruara; nuk do të shohin në të as vapë, e as acar.

مُتَّكِنِينَ فِيهَا عَلَى الْأَرَائِكِ ۗ لَا يَرَوْنَ  
فِيهَا شَمْسًا وَلَا زَمْهَرِيرًا ﴿١٤﴾

15. Ai (xhenet) do t'i përhijojë ata, edhe frutat e tij do të jenë të varura deri poshtë.

وَ دَانِيَةً عَلَيْهِمْ ظِلُّهَا وَ ذُلِّلَتْ قُطُوفُهَا  
تَذَلِيلًا ﴿١٥﴾

16. Do t'u shërbehët vazhdimisht me enë prej argjendi dhe kupa prej qelqi;

وَيَطُوفُ عَلَيْهِمْ بِلَيْتِهِ مِّنْ فِضَّةٍ وَأَكْوَابٍ  
كَانَتْ قَوَارِيرًا ۝١٠

17. prej një qelqi të argjendtë, të cilat (engjëjt) do t'i përgatisin me mjeshtëri.

قَوَارِيرًا مِّنْ فِضَّةٍ قَدَّرُوهَا تَقْدِيرًا ۝١١

18. Aty do të pinë nga një kupë, që do të jetë e përzier me xhenxhefil.<sup>3</sup>

وَيَسْقُونَ فِيهَا كَأْسًا كَانَ مِزَاجُهَا زَنْجَبِيلًا ۝١٢

19. Në të do të ketë një burim, që quhet Selsebil.

عَيْنًا فِيهَا تُسْقَى سَلْسَبِيلًا ۝١٣

20. Bij të përjetshëm<sup>4</sup> do të sillen rreth tyre. Kur do t'i shohësh ata, do të mendosh se janë perla të shpërndara.

وَيَطُوفُ عَلَيْهِمْ وِلْدَانٌ مُّحَلَّدُونَ ۚ إِذَا رَأَيْتَهُمْ حَسِبْتَهُمْ لُؤْلُؤًا مَّنثُورًا ۝١٤

21. Dhe kur të vështrosh, atje do të shohësh begati e sundim shumë të madh.

وَإِذَا رَأَيْتَ ثَمَّ رَأَيْتَ نَعِيمًا وَ مَلَكًا كَبِيرًا ۝١٥

22. Ata do të jenë me veshje mëndafshi të hollë ngjyrë të gjelbër, si dhe mëndafshi të trashë, dhe të stolitur me byzylykë argjendi. Dhe Zoti i tyre do t'u japë për të pirë një pije të pastër.

عَلَيْهِمْ ثِيَابٌ سُنْدُسٌ خُضْرٌ وَاسْتَبْرَقٌ ۚ وَحُلُوهَا أَسَاوِرٌ مِّنْ فِضَّةٍ وَسَقْمُهُمْ رَبَّهُمْ شَرَابًا طَهُورًا ۝١٦

23. Sigurisht, kjo do të jetë për ju si shpërblim, dhe përpjekja juaj do të ketë mirënjohje.

إِنَّ هَذَا كَانَ لَكُمْ جَزَاءً وَكَانَ سَعْيُكُمْ مَشْكُورًا ۝١٧

24. Pa dyshim, Ne e kemi zbritur mbi ty Kuranin gradualisht.

إِنَّا نَحْنُ نَزَّلْنَا عَلَيْكَ الْقُرْآنَ تَنْزِيلًا ۝١٨

3. Për kuptime të thella të dy pijeve që janë përmendur në këtë sure, lexoni librin “Filozofia e mësimëve të Islamit”, nga Hazret Mirza Ghulam Ahmed<sup>as</sup>, botuar në Tiranë, 2019.

4. Lexoni shënimin te 56:18.

25. Andaj, duro për (të zbatuar) urdhrin e Zotit tënd dhe mos ndiq asnjë mëkatar a mosmirënjohës të tyre.

فَاصْبِرْ لِحُكْمِ رَبِّكَ وَلَا تُطِعْ مِنْهُمْ آيْمًا  
أَوْ كُفُورًا ﴿٢٥﴾

26. Përkuju to emrin e Zotit tënd në mëngjes e në mbrëmje.

وَاذْكُرْ اسْمَ رَبِّكَ بُكْرَةً وَأَصِيلًا ﴿٢٦﴾

27. Dhe në një pjesë të natës bëji sexhde Atij, dhe lartësoje Atë natën gjatë.

وَ مِنْ أَيْلٍ فَاسْجُدْ لَهُ وَسَبِّحْهُ لَيْلًا  
طَوِيلًا ﴿٢٧﴾

28. Pa dyshim, këta e dashurojnë botën<sup>5</sup> dhe anashkalojnë një ditë shumë të rëndë që kanë përpara.

إِنَّ هَؤُلَاءِ يُحِبُّونَ الْعَاجِلَةَ وَيَذَرُونَ  
وَرَاءَهُمْ يَوْمًا ثَقِيلًا ﴿٢٨﴾

29. Ne i kemi krijuar ata dhe ua kemi forcuar strukturën, dhe kur të duam, do t'ua ndryshojmë formën tërësisht.

نَحْنُ خَلَقْنَاهُمْ وَشَدَدْنَا أَسْرَهُمْ ۚ وَإِذَا  
شِئْنَا بَدَّلْنَا أَمْثَالَهُمْ تَبْدِيلًا ﴿٢٩﴾

30. Sigurisht, kjo është një këshillë. Andaj, kush të dojë, le të marrë udhë drejt Zotit të tij.

إِنَّ هَذِهِ تَذْكِرَةٌ ۚ فَمَنْ شَاءَ اتَّخَذَ إِلَىٰ رَبِّهِ  
سَبِيلًا ﴿٣٠﴾

31. Dhe ju nuk mund të doni (që diçka të bëhet), përveçse nëse e do Allahu. Sigurisht, Allahu është i Gjithëdijshëm, i Urtë.

وَمَا تَشَاءُونَ إِلَّا أَنْ يَشَاءَ اللَّهُ ۗ إِنَّ اللَّهَ  
كَانَ عَلِيمًا حَكِيمًا ﴿٣١﴾

32. Ai merr kë të dojë në mëshirën e Tij, kurse për keqbërësit, Ai ka përgatitur ndëshkim të dhimbshëm.

يُدْخِلُ مَنْ يَشَاءُ فِي رَحْمَتِهِ ۗ وَالظَّالِمِينَ  
يَعِدُّ لَهُمْ عَذَابًا أَلِيمًا ﴿٣٢﴾

5. Lexoni shënimin te 75:21.

## Surja 77 – El-Murselat

Surja El-Murselat zbriti në Mekë dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka pesëdhjetë e një ajete.

Që në fillim të kësaj sureje parashikohen ngjarje që do të ndodhnin në epokën e *të mëvonshmëve* dhe që lidhen me zhvillimin e shkencës dhe të teknologjisë. Kjo për të provuar se Ai Allah që e ka parashikuar këtë të padukshme, është i Plotfuqishëm edhe për të sjellë në botë çdolloj ndryshimi të madh. Kështu që, kjo sure parashikon për disa fluturake, të cilat në fillim janë të ngadalta, e më pas do të jenë të shpejta si stuhi. Në këtë kohë kjo pamje u ngjan avionëve, sidomos atyre luftarakë, të cilët nisen ngadalshëm e më pas arrijnë një shpejtësi të jashtëzakonshme. Me këta avionë shpërndahen fletushka e njoftime gjatë luftërave, për të krijuar dallimin dhe për t'u bërë thirrje njerëzve: Nëse jeni me ne, edhe ne do t'ju ndihmojmë, përndryshe nuk mund t'ju shpëtojë dot askush nga ne.

Më pas thotë: Kur yjet do të zbehen, dhe kur njeriu do të bëjë përpjekje të ndryshme për t'u ngjitur në qiell. Zbehja e yjeve, me sa duket, nënkupton përfundimin e periudhës së sahabëve<sup>ra</sup> të Profetit, për nga ndikimi i tyre. Pra, drita që mernte *umeti* i Profetit prej këtyre yjeve, do të zbehej.

Më pas tha: Kur superfuqitë që u ngjajnë maleve, do të shkulen, dhe atëherë do të ridërgohen të gjithë të Dërguarit. Dijetarë të ndryshëm e keqinterpretojnë këtë ajet duke e përshkruar atë si pamje të Ditës së Kiametit, sepse Ditën e Kiametit as nuk shkulen malet, e as nuk dërgohen Profetët. Profetët dërgohen në këtë botë që njerëzimi të mësojë prej tyre. Andaj, kjo profeci e Kuranit të Shenjtë parashikon që, në shërbim të plotë të Kuranit dhe të Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, do të shfaqej një Profet, ardhja e të cilit do të ngjasonte me ardhjen e të Dërguarve të tjerë. Pra, përpjekja e tij do të synonte bashkimin e *umetit* të secilit Profet të mëparshëm në *umetin* e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>.

Parashikimet vijnë, por ato janë në një gjuhë që mund të kenë kuptime të ndryshme. Njëri prej kuptimeve aplikohet në mënyrë të goditur edhe për luftërat që do të bëheshin në të ardhmen. Një shenjë, për shembull, është që ato do të jenë në tre sektorë. Siç luftërat e epokës sonë bëhen në tokë, det dhe ajër. Po kështu thotë se qielli do të lëshojë flakë të tilla që do t'u përngjajnë kështjellave, sikur të ishin deve me ngjyrë të errëta. Këto dy ajete tregojnë qartë se kjo është një gjuhë e figurshme. Në kohën e të Dërguarit të Allahut<sup>savs</sup> nuk kishte asnjë koncept të luftërave të tilla që mund të lëshonin zjarr prej qiellit. Andaj, kjo është një profeci nga i Gjithëdijshmi Zot, i cili e di edhe të ardhmen. Përveç kësaj, zjarri nuk bie prej qiellit në funksion të Ditës së Kiametit të madh, andaj, duket se këtu kemi të bëjmë me një profeci që flet për luftëra atomike, gjë që përmendet edhe në suren 44, Ed-Dukhan (Tymi), që, atë ditë qielli do të lëshojë valë radioaktive, të cilat këdo që do ta prekin, do t'ia rrëmbejnë qetësinë.

Ajetet në vijim përmendin detajet e botës së përtejme, duke i tërhequr vëmendje njerëzimit: nëse do të plotësohen profecitë që janë përmendur në këtë sure, duhet të jeni të bindur se edhe bota e përtejme do të bëhet patjetër; nëse e keni mohuar Krijuesin në këtë botë, dhe nëse keni ndërtuar një botë skëterre rreth vetes, edhe në botën e përtejme do të vuani në një ferr të tmerrshëm.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Beto hem për ato që dërgohen njëra pas tjetrës!

وَالْمُرْسَلَاتِ عُرْفًا ②

3. Për ato që më pas marrin shpejtësi të stuhishme!

فَالْعَصْفِ عَصْفًا ③

4. Dhe për shpërndarëset (e mesazhit) anekënd!

وَالنَّشْرِ نَشْرًا ④

5. Dhe për ato që, më pas, bëjnë dallimin e qartë!

فَانْفَرَقَتْ فَرَقًا ⑤

6. Dhe për ato që lëshojnë skripte!

فَانْمُلُكِيَتْ ذِكْرًا ⑥

7. Qoftë si argument, qoftë si kërcënim!

عُدْرًا أَوْ نُذْرًا ⑦

8. Ajo që ju paralajmërohet, do të ndodhë pashmangshmërisht.

إِنَّمَا تُوعَدُونَ لَوَاقِعٌ ⑧

9. Atëherë kur yjet të zbehen;

فَإِذَا التَّجُومُ طُمِسَتْ ⑨

10. dhe kur qielli të shpohet;

وَإِذَا السَّمَاءُ فُرِجَتْ ⑩

11. dhe kur malet të thërrmohen;

وَإِذَا الْجِبَالُ نُسِفَتْ ⑪

12. dhe kur të Dërguarit të shfaqen në kohën e caktuar.

وَإِذَا الرُّسُلُ أُقِتَتْ ⑫

13. Për cilën ditë ata ishin caktuar?

لِأَيِّ يَوْمٍ أُجِّلَتْ ⑬

14. Për ditën vendimtare.

لِيَوْمِ الْفَصْلِ ⑭



15. E si mund ta dish ti se çfarë është dita vendimtare?

وَمَا آذْرَبِكَ مَا يَوْمَ الْفَصْلِ ۝١٥

16. Atë ditë, u shkatërrofshin mohuesit!

وَيَلَّ يَوْمَئِذٍ لِلْمُكَذِّبِينَ ۝١٦

17. A nuk i kemi shfarosur të parët?!

أَلَمْ نُهْلِكِ الْأَوَّلِينَ ۝١٧

18. Më pas, i sjellim edhe të mëvonshmit pas tyre.

ثُمَّ نُنَبِّئُهُمُ الْآخِرِينَ ۝١٨

19. Ne kështu bëjmë me fajtorët.

كَذَلِكَ نَفْعَلُ بِالْمُجْرِمِينَ ۝١٩

20. Atë ditë, u shkatërrofshin mohuesit!

وَيَلَّ يَوْمَئِذٍ لِلْمُكَذِّبِينَ ۝٢٠

21. A nuk ju kemi krijuar prej një uji të parëndësishëm!

أَلَمْ نَخْلُقْكُمْ مِنْ مَّاءٍ مَّهِينٍ ۝٢١

22. të cilin më pas e vumë në një vend të sigurt,

فَجَعَلْنَاهُ فِي قَرَارٍ مَّكِينٍ ۝٢٢

23. deri në një masë të caktuar (kohe)?!

إِلَىٰ قَدَرٍ مَّعْلُومٍ ۝٢٣

24. Më pas e përcaktuam (atë), dhe sa Përcaktues të mirë Jemi!

فَقَدَرْنَا فَنِعْمَ الْقَادِرُونَ ۝٢٤

25. Atë ditë, u shkatërrofshin mohuesit!

وَيَلَّ يَوْمَئِذٍ لِلْمُكَذِّبِينَ ۝٢٥

26. A nuk e bëmë tokën që të mbajë,

أَلَمْ نَجْعَلِ الْأَرْضَ كِفَاتًا ۝٢٦

27. edhe të gjallët, edhe të vdekurit?!

أَحْيَاءٍ وَ أَمْوَاتًا ۝٢٧

28. Dhe në të bëmë male të larta, dhe ju dhamë ujë të pijshëm.

وَجَعَلْنَا فِيهَا رَوَاسِيَ شِمَخَاتٍ وَأَسْقَيْنَاكُم مَّاءً فُرَاتًا ۝٢٨

مَاءً فُرَاتًا ۝٢٨

29. Atë ditë, u shkatërrofshin mohuesit!

وَيْلٌ يَوْمَئِذٍ لِلْمُكَذِّبِينَ ﴿٢٩﴾

30. Ecni drejt asaj që e quanit gënjeshtër!

انْطَلِقُوا إِلَى مَا كُنتُمْ بِهِ تُكَذِّبُونَ ﴿٣٠﴾

31. Ecni drejt një hijeje që ka tri degë,

انْطَلِقُوا إِلَى ظِلٍّ ذِي ثَلَاثِ شُعَبٍ ﴿٣١﴾

32. as nuk jep hije dhe as nuk shpëton nga flakët.

لَا ظَلِيلٍ وَلَا يُعْنِي مِنَ اللَّهِ ﴿٣٢﴾

33. Ajo lëshon një flakë si një kështjellë,

إِنهَا تَرْمِي بِشَرِّ رِكَازٍ مُصَفًّى ﴿٣٣﴾

34. sikur të jenë deve të errëta.

كَأَنَّهُ جِمَلَاتٌ صُفْرٌ ﴿٣٤﴾

35. Atë ditë, u shkatërrofshin mohuesit!

وَيْلٌ يَوْمَئِذٍ لِلْمُكَذِّبِينَ ﴿٣٥﴾

36. Kjo është dita kur ata nuk do të flasin dot.

هَذَا يَوْمٌ لَا يَنْطِقُونَ ﴿٣٦﴾

37. Nuk do të lejohen të japin justifikime.

وَلَا يُؤْذَنُ لَهُمْ فَيَعْتَذِرُونَ ﴿٣٧﴾

38. Atë ditë, u shkatërrofshin mohuesit!

وَيْلٌ يَوْمَئِذٍ لِلْمُكَذِّبِينَ ﴿٣٨﴾

39. Kjo është dita vendimtare. Ne ju mblodhëm ju dhe të parët.

هَذَا يَوْمُ الْفَصْلِ ۚ جَمَعْنَاكُمْ وَالْأُولَىٰ ﴿٣٩﴾

40. Nëse keni ndonjë taktikë, bëjeni kundër Meje!

فَإِنْ كَانَ لَكُمْ كَيْدٌ فَكِيدُوا ﴿٤٠﴾

41. Atë ditë, u shkatërrofshin mohuesit!

وَيْلٌ يَوْمَئِذٍ لِلْمُكَذِّبِينَ ﴿٤١﴾

42. Pa dyshim, të druajturit (ndaj Zotit) do të jenë në (xhenete me) hije e burime;

إِنَّ الْمُتَّقِينَ فِي ظِلِّ وَعُيُونٍ ۝٤٢

43. dhe fruta, që ata do t'i pëlqejnë.

وَفَوَاكِهَ مِمَّا يَشْتَهُونَ ۝٤٣

44. “Hani e pini lirshëm për atë që keni punuar!”

كُلُوا وَاشْرَبُوا هَنِيئًا بِمَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ ۝٤٤

45. Ne kështu i shpërblejmë mirëbërësit.

إِنَّا كَذَلِكَ نَجْزِي الْمُحْسِنِينَ ۝٤٥

46. Atë ditë, u shkatërrofshin mohuesit!

وَيَلَّ يَوْمَئِذٍ لِلْمُكَذِّبِينَ ۝٤٦

47. “Hani dhe përfitoni për një kohë të shkurtër! Ju përnjëmend jeni fajtorë!”

كُلُوا وَتَمَتَّعُوا قَلِيلًا إِنَّكُمْ مُّجْرِمُونَ ۝٤٧

48. Atë ditë, u shkatërrofshin mohuesit!

وَيَلَّ يَوْمَئِذٍ لِلْمُكَذِّبِينَ ۝٤٨

49. E kur atyre u thuhet: “Përkuluni”, nuk përkulen.

وَإِذَا قِيلَ لَهُمْ ارْكَعُوا لَا يَرْكَعُونَ ۝٤٩

50. Atë ditë, u shkatërrofshin mohuesit!

وَيَلَّ يَوْمَئِذٍ لِلْمُكَذِّبِينَ ۝٥٠

51. Andaj, cilën fjalë do ta besojnë ata pas kësaj?!

يَعْفَىٰ فَبِأَيِّ حَدِيثٍ بَعْدَهُ يُؤْمِنُونَ ۝٥١

## Surja 78 – En-Nebe

Surja En-Nebe është zbritur në periudhën e hershme mekase dhe, bashkë me *bismillahin*, ka dyzet e një ajete.

Në suren paraardhëse, El-Murselat, një pyetje thelbësore ishte ngritur nga mohuesit: “Kur do të ndodhë dita vendimtare?” Pra, dita që do të dallojë të pastrin nga i papastri. Duke iu përgjigjur kësaj pyetjeje, surja Nebe jep lajmin madhështor se ajo ditë vendimtare ka ardhur. Kjo sure gjithashtu pohon se premtimi për ditën vendimtare do të plotësohet patjetër në kohën e saj.

Më pas, kjo sure tregon forma të ndryshme të “ditës vendimtare”. Së pari paraqet sistemin që ka krijuar Allahu i Madhërisëm për zbritjen e ujit nga qielli dhe për ushqimet që dalin prej toke për shkak të këtij uji. Më pas, u tërheq vërejtjen njerëzve, të cilët nuk përfitojnë nga ky ligjërimit për shkak se nuk mendojnë se uji i vërtetë në fakt është uji shpirtëror e qiellor, që zbret për udhëzimin e tyre. Kjo sure gjithashtu përmend fatkeqësitë që bien ose që do të bien në të ardhmen për shkak të mohimit të ujit shpirtëror.

Në fund, kjo sure paralajmëron për diçka shumë të madhe: nëse njeriu do ta vijojë jetën në shkujdesje, do të përfundojë në dëshpërim aq të thellë, sa që me dhimbje të madhe do të shprehet – Ah, sikur të bëhesha dhe, e të mos ngrihesha më si njeri!

Ajetet:  
41سُورَةُ النَّبَاِ  
78. EN-NEBE  
MekaseRukutë:  
2

Xhuzi 30

1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit. بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①
2. Për çfarë po pyesin njëri-tjetrin? عَمَّ يَتَسَاءَلُونَ ②
3. Për një lajm madhështor. عَنِ النَّبَاِ الْعَظِيمِ ③
4. Pikërisht për atë të cilin ata e kundërshtojnë. الَّذِي هُمْ فِيهِ مُخْتَلِفُونَ ④
5. Por, së shpejti do të mësojnë! كَلَّا سَيَعْلَمُونَ ⑤
6. Sërish, së shpejti do të mësojnë! ثُمَّ كَلَّا سَيَعْلَمُونَ ⑥
7. A nuk e bëmë tokën si shtrat; أَلَمْ نَجْعَلِ الْأَرْضَ مِهْدًا ⑦
8. dhe malet si gozhdë të ngulitura?! وَأَنْجِبَالَ أَوْتَادًا ⑧
9. Dhe ju krijuam çifte. وَخَلَقْنَاكُمْ أَزْوَاجًا ⑨
10. Gjumin jua bëmë pushim. وَجَعَلْنَا نَوْمَكُمْ سُبَاتًا ⑩
11. Natën e bëmë mbulesë. وَجَعَلْنَا اللَّيْلَ لِبَاسًا ⑪
12. Dhe ditën e bëmë jetesë. وَجَعَلْنَا النَّهَارَ مَعَاشًا ⑫
13. Sipër jush bëmë shtatë qiej të fortë.<sup>1</sup> وَبَيْنَا فَوْقَكُمْ سَبْعًا شِدَادًا ⑬
14. Bëmë edhe një llambë ndriçuese. وَجَعَلْنَا سِرَاجًا وَهَّاجًا ⑭
15. Lëshojmë ujë të rrjedhshëm prej reve të gatshme të pikojnë. وَ أَنْزَلْنَا مِنَ الْمُعْصِرَاتِ مَاءً ثَجَّاجًا ⑮

1. Këtu fjala "qiej" në arabisht është e nënkuptuar, edhe pse nuk gjendet në fjali, andaj, në përkthim nuk e kemi lënë në kllapa.

16. Që të nxjerrim përmes tij drithëra  
e bimësi;

لِنُخْرِجَ بِهِ حَبًّا وَنَبَاتًا ۗ

17. dhe pyje të dendura.

وَجَنَّتِ الْأَقَا۟فَ ۗ

18. Sigurisht, dita e vendimit e ka  
një kohë të caktuar.

إِنَّ يَوْمَ الْفُصْلِ كَانَ مِيقَاتًا ۗ

19. Ditën kur t'i fryhet bririt, ju do të  
vini grupe-grupe.

يَوْمَ يُنْفَخُ فِي الصُّورِ فَتَأْتُونَ أَفْوَاجًا ۗ

20. Qielli do të çelet dhe do të bëhet  
me porta.

وَفُتِحَتِ السَّمَاءُ فَكَانَتْ أَبْوَابًا ۗ

21. Dhe malet do të lëvizin dhe do të  
bëhen mirazhe.<sup>2</sup>

وَسُيِّرَتِ الْجِبَالُ فَكَانَتْ سَرَابًا ۗ

22. Sigurisht, xhehenemi rri në  
pritë,

إِنَّ جَهَنَّمَ كَانَتْ مِرْصَادًا ۗ

23. që në të të bien rebelët.

لِلطَّاغِي۟تِۙنَ مَابًا ۗ

24. Ata do të mbesin atje për shekuj.<sup>3</sup>

لِيُثَبِّتَ فِيهَا أَحْقَابًا ۗ

2. Një nga kuptimet e fjalës “serab” (mirazh), që jep Imam Er-Ragib el-Isfahani në “Mufredat Elfadhul-Kuran” është “serab: lëvizje drejt ultësirës”. Kështu që, ajeti mund të përkthehet edhe si vijon: “Dhe malet do të lëvizin për t'u rrëshqitur drejt ultësirës”.

3. Kurani i Shenjtë në shumë ajete të tjera e mbështet idenë se xhehenemi nuk është përgjithmonë. Disa prej tyre janë: (1) “... mëshira Ime përfshin çdo gjë” (7:157), e në një ajet tjetër na mëson lutjen: “O Zoti ynë! Ti sundon çdo gjë me mëshirë dhe dije...” (40:8). Kështu, një ditë mëshira e Zotit do ta përfshijë edhe xhehenemin. (2) Duke përshkruar qëndrimin e banorëve të xhehenemit, Kurani e kufizon me një periudhë dhe thotë: “Ata do të mbesin atje për shekuj” (78:24). Në komentim të këtij ajeti, përmendet edhe hadithi: Xhehenemit patjetër do t'i vijë një kohë, kur kanatet e portave të tij do të përplasen, kur nuk do të ketë njeri në të. (Taberi, 11:107). Në një hadith tjetër Profeti Muhammed<sup>saws</sup> përshkruan ditën kur banuesi i fundit i xhehenemit do të hyjë në parajsë (Muslim, 368). (3) Zoti thotë në Kuran se vepra e mirë do të shpërblehet më shumë se dhjetëfish (2:262), kurse vepra e keqe do të dënohet aq sa është ajo vepër (40:41). Kjo llogaritje logjikisht do t'i asgjësojë të këqijat. (4) Zoti bën dy përshkrime të ndryshme të xhenetit dhe të xhehenemit, për sa i përket qëndrimin të banorëve të tyre përkatëse në to (11:109). (5) Për atë që do të ketë më pak vepra të mira, Kurani pohon “nëna e tij” do të jetë *havije* (xhehenemi) (101:10). “Nëna” përveçse luan rolin e burimit, luan edhe rolin e kalimit të jetës nga një fazë në fazën tjetër më të zhvilluar. Më shumë rreth kësaj

25. Atje nuk do të shijojnë dot as freski e as ndonjë pije, لَا يَذُوقُونَ فِيهَا بَرْدًا وَلَا شَرَابًا ۝
26. por vetëm ujë të valuar dhe qelb; إِلَّا حَمِيمًا وَعَسَاقًا ۝
27. si shpërblim të merituar. جَزَاءً وَفَاقًا ۝
28. Ata nuk prisnin fare ndonjë llogaridhënie. إِنَّهُمْ كَانُوا لَا يَرْجُونَ حِسَابًا ۝
29. Me kokëfortësi i quajten gënjeshtër ajetet Tona. وَكَذَّبُوا بِآيَاتِنَا كِذَابًا ۝
30. Dhe Ne kemi ruajtur çdo gjë në një libër.<sup>4</sup> وَكُلَّ شَيْءٍ أَحْصَيْنَاهُ كِتَابًا ۝
31. “Andaj, shijoni! Ne do t’ju shtojmë vetëm ndëshkimin!” فَذُوقُوا فَلَنْ نَزِيدَكُمْ إِلَّا عَذَابًا ۝
32. Sigurisht, për të devotshmit<sup>5</sup> ka një fitore, إِنَّ لِلْمُتَّقِينَ مَفَازًا ۝
33. pemishte e hardhi, حَدَائِقَ وَأَعْنَابًا ۝
34. të virgjëra moshatare, وَكَوَاعِبَ أَتْرَابًا ۝
35. dhe kupa të tejmbushura. وَكَأْسًا دِهَاقًا ۝
36. Ata nuk do të dëgjojnë atje as kotësi, e as ndonjë gënjeshtër të vogël. لَا يَسْمَعُونَ فِيهَا لُعَاوًا وَلَا كِذَابًا ۝
37. Kjo si shpërblim prej Zotit tënd (dhe) një dhuratë e merituar; جَزَاءً مِّن رَّبِّكَ عَطَاءً حِسَابًا ۝

teme, lexoni 11:109.

4. Shpikja e mjeteve të telekomunikacionit dhe e instrumenteve të tjera të ngjashme ka vërtetuar faktin se jo vetëm veprimi i njeriut, por edhe fjalët e tij mund të ruhen dhe të riprodhohen.

5. Për të drujturit ndaj Zotit, pra ata që kanë *takva*.

38. prej Zotit të qiejve, të tokës dhe të gjithçkaje që gjendet mes tyre; (prej) të Gjithëmëshirshmit. Ata nuk do të kenë fuqi t'i drejtohen Atij.

رَبِّ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا  
الرَّحْمَنِ لَا يَمْلِكُونَ مِنْهُ خِطَابًا ۝٣٨

39. Ditën kur do të qëndrojnë të rreshtuar Shpirti i Shenjtë dhe engjëjt; nuk do të flasin, përveç atij, të cilin do ta lejojë i Gjithëmëshirshmi, dhe ai do të flasë vetëm drejt.<sup>6</sup>

يَوْمَ يَقُومُ الرُّوحُ وَالْمَلَائِكَةُ صَفًّا  
لَّا يَتَكَلَّمُونَ إِلَّا مَنْ أذِنَ لَهُ الرَّحْمَنُ  
وَقَالَ صَوَابًا ۝٣٩

40. Kjo është dita e së vërtetës, prandaj kush të dojë, le të sigurojë një vendkthim te Zoti i tij.

ذَلِكَ الْيَوْمُ الْحَقُّ ۚ فَمَنْ شَاءَ اتَّخَذْ إِلَىٰ  
رَبِّهِ مَآبًا ۝٤٠

41. Sigurisht, Ne ju kemi paralajmëruar për një ndëshkim të afërt. Ditën kur njeriu do ta shohë atë që duart e tij kanë çuar përpara, dhe mohuesi do të thotë: “Mjerë unë! Sikur të isha dhe!”

إِنَّا أَنْذَرْنَاكُمْ عَذَابًا قَرِيبًا ۗ يَوْمَ يَنْظُرُ  
الْمَرْءُ مَا قَدَّمَتْ يَدَهُ وَيَقُولُ الْكَافِرُ  
يَلَيْتَنِي كُنْتُ تُرَابًا ۝٤١

6. Ditën e Gjykimit askush nuk do të ketë të drejtën e ndërmjetësimit, përveç atij të cilin do ta lejojë Allahu i Madhërishëm. Fuqia e Allahut do të jetë aq e madhe saqë, do të ketë heshtje të plotë. Dhe kushdo që do të lejohet të flasë, do të flasë vetëm të vërtetën. Askush nuk do të ketë mundësi të gënjejë përpara Tij.



## Surja 79 – En-Naziat

Surja En-Naziat është zbritur në periudhën e hershme mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka dyzet e shtatë ajete.

Sipas një metodologjie të ndjekur nga Kurani, edhe një herë vijnë parashikimet për ndëshkime të kësaj bote dhe për luftëra. Kjo sure flet, ndër të tjera, edhe për luftëra të atilla ku do të përdoreshin nëndetëse. Një kuptim i ajetit “Betohem për ato që rrëmbejnë duke u zhytur!”, është që këto mjete luftarake zhyten në ujë me qëllim që të mbysin armikun e tyre, dhe më pas të gëzohen për çdo fitore të tyre. Kjo garë e luftërave konsumohet duke parakaluar njëri-tjetrin, ndërkohë që të dyja palët tentojnë të përdorin strategjitë më të forta të mundshme.

“Betohem për ato që notojnë shumë!”, janë anijet që lundrojnë nëpër oqeanë, por edhe ato nëndetëse, të cilat pasi shënojnë një fitore, dalin në sipërfaqen e ujit për ta festuar.

Shkurt, këto luftëra shkaktojnë një llahtari që trondit zemrat dhe i ul shikimet nga frika. Pas kësaj katastrofe tokësore, ndërgjegjja e njeriut do të ngrrej pyetjen – A do të ringjallemi sërish, pasi edhe eshtrat tona të kalben tërësisht?! Dhe Zoti i përgjigjet – Po patjetër, madje, do të ketë një ushtimë paralajmëruese, pas së cilës, i gjithë njerëzimi do të paraqitet në fushën e Gjykimit të Madh.

Pas kësaj, kjo sure përmend *Hazret Musain*<sup>as</sup>, sepse Zoti atë e kishte dërguar drejt Faraonit, i cili pretendonte të ishte vetë Zoti, dhe në mënyrë këmbëngulëse e mohonte botën e përtejme. Kur *Hazret Musai*<sup>as</sup> ia kumtoi mesazhin, ai me mendjemadhësi kokëforte iu përgjigj – Zoti yt i Lartësuar jam unë! Prandaj, Allahu i Madhërishtëm e ndëshkoi në atë mënyrë që e la mësim për gjithë brezninë e tij dhe për të gjithë të mëvonshmit. Populli i tij dëshmoi faktin sesi ai u zhyt me tërë ushtrinë e tij, kurse të mëvonshmit marrin mësim duke parë mumien e tij, sepse ai u shpëtua nga mbytja në ujë në gjendje për t’u lënguar në shtratin e vdekjes për një kohë të gjatë dhe për t’u mumifikuar pas vdekjes, që të mbetet si mësim për brezat e ardhshëm.

Më pas, surja mbyllet duke përsëritur pyetjen e njerëzve – Ora e *ahiretit* kur dhe si do të vijë? Dhe duke iu përgjigjur kësaj pyetjeje, pohon – Kur do të vijë ajo, do të bëjë të qartë se fundi i saj është vetëm te Zoti yt, dhe ti, o i Dërguar, mund të alarmosh vetëm atë që i frikësohet asaj Ore; gjithashtu, kur njerëzit do të përballen me Orën, do të kuptojnë që në botë nuk kanë jetuar më shumë se disa çaste.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Beto hem për ato që rrëmbejnë duke u zhytur!

وَالْتُرَعْتَ عَرْقًا ①

3. Dhe për ato që gëzohen pa masë!

وَالنَّشِطِ نَشْطًا ①

4. Dhe për ato që lundrojnë shumë!

وَالسَّيْحِ سَبْحًا ①

5. Dhe për ato që, më pas, parakalojnë njëra-tjetrën!

فَالسَّيْقِ سَبْقًا ①

6. Dhe për ato që bëjnë plan!

فَالْمَدْبِرَاتِ أَمْرًا ①

7. Ditën kur do të tronditet fort ajo që tronditet;

يَوْمَ تَرْجُفُ الرَّاجِفَةُ ①

8. pasuesja do ta pasojë atë.

تَتَّبِعَهَا الرَّادِفَةُ ①

9. Zemrat atë ditë do të rrahin shpejt.

قُلُوبٌ يَوْمَئِذٍ وَاجِفَةٌ ①

10. Shikimet e tyre do të jenë përdhe.

أَبْصَارُهَا خَاشِعَةٌ ①

11. (Njerëzit) do të pohojnë: “A do të kthehem në gjendjen e mëparshme?!”

يَقُولُونَ ءِ إِنَّا لَمَرْدُودُونَ فِي الْحَافِرَةِ ①

12. Edhe atëherë kur të jemi eshtra të kalbura?!”

ءِ إِذَا كُنَّا عِظَامًا نَّخْرَةً ①

13. Ata do të thonë: “Atëherë ky qenka një kthim humbës!”

قَالُوا تِلْكَ إِذًا كَرَّةٌ خَاسِرَةٌ ①

14. Pa dyshim, ajo do të jetë një qortim i vetëm.

فَإِنَّمَا هِيَ زَجْرَةٌ وَاحِدَةٌ ①

15. Dhe papritmas ata do të gjenden në fushën e gjerë.

فَإِذَا هُمْ بِالسَّاهِرَةِ ۝١٥

16. A të erdhi lajmi për Musain?

هَلْ أَتَاكَ حَدِيثُ مُوسَى ۝١٦

17. Kur atë e thirri Zoti i tij në luginën e shenjtë Tuva:

إِذْ نَادَاهُ رَبُّهُ بِأَنوَادِ الْمُقَدَّسِ طُوًى ۝١٧

18. “Shko drejt Faraonit, se ai u rebelua;

إِذْهَبْ إِلَى فِرْعَوْنَ إِنَّهُ طَغَى ۝١٨

19. Dhe pyete: ‘A dëshiron të dëlirësohesh?’

فَقُلْ هَلْ لَكَ إِلَىٰ أَن تَزْكَىٰ ۝١٩

20. Dhe unë të të udhëzoj te Zoti yt, që të kesh frikë (ndaj Tij)?”

وَأَهْدِيكَ إِلَىٰ رَبِّكَ فَتَخْشَىٰ ۝٢٠

21. Më pas ai i tregoi një shenjë shumë të madhe.

فَأَرَاهُ الْآيَةَ الْكُبْرَىٰ ۝٢١

22. Atëherë (Faraoni e) quajti gënjeshtër dhe kundërshtoi.

فَكَذَّبَ وَعَصَىٰ ۝٢٢

23. Më pas me nxitim ia ktheu shpinën.

ثُمَّ أَدْبَرَ يَسْعَىٰ ۝٢٣

24. Mblodhi (turmën) dhe thirri.

فَحَشَرَ فَنَادَىٰ ۝٢٤

25. E tha: “Unë jam Zoti juaj më i larti!”

فَقَالَ أَنَا رَبُّكُمُ الْأَعْلَىٰ ۝٢٥

26. Atëherë Allahu e ndëshkoi duke e bërë mësim për të mëvonshmit dhe për të parët.

فَأَخَذَهُ اللَّهُ نَكَالَ الْآخِرَةِ وَالْأُولَىٰ ۝٢٦

27. Pa dyshim, në të ka mësim për çdokënd që ka frikë.

بَلْ إِنَّ فِي ذَٰلِكَ لَعِبْرَةً لِّمَن يَخْشَىٰ ۝٢٧

28. A jeni ju më të vështirë në krijim, apo qielli që (Zoti) ka ndërtuar?!<sup>1</sup> ءَأَنْتُمْ أَشَدُّ حَلْقًا أَمَ السَّمَاءُ طَبَّ بِنُهَا ۞<sup>(79)</sup>
29. Të cilin Ai e ngriti lart dhe shumë mirë e rregulloi. رَفَعَ سَمَكَهَا فَسَوَّيَهَا ۞<sup>(80)</sup>
30. Ia errësoi natën dhe ia zdriti ditën. وَأَغْطَشَ لَيْلَهَا وَأَخْرَجَ ضُحَاهَا ۞<sup>(81)</sup>
31. Pas kësaj, edhe tokën e rrafshoi. وَالْأَرْضَ بَعْدَ ذَلِكَ دَحَاهَا ۞<sup>(82)</sup>
32. Nxori ujin dhe barishten<sup>2</sup> prej saj. أَخْرَجَ مِنْهَا مَاءَهَا وَمَرْعَاهَا ۞<sup>(83)</sup>
33. Dhe malet i nguliti; وَالْجِبَالَ أَرْسَاهَا ۞<sup>(84)</sup>
34. si mjet jetese për ju dhe për bagëtitë tuaja.<sup>3</sup> مَتَاعًا لَكُمْ وَلِأَنْعَامِكُمْ ۞<sup>(85)</sup>
35. Pra, kur do të vijë më e madhja gjëmë; فَإِذَا جَاءَتِ الطَّامَةُ الْكُبْرَى ۞<sup>(86)</sup>
36. ditën kur njeriu do të kujtojë se për çfarë është përpjekur; يَوْمَ يَنْدَكُرُ الْإِنْسَانُ مَا سَعَى ۞<sup>(87)</sup>
37. dhe do t'i zbulohet xhehenemi atij që (deri tani) e shihte (vetëm duke përfytyruar). وَبُرِّزَتِ الْجَحِيمُ لِمَنْ يَرَى ۞<sup>(88)</sup>
38. Pra, ai që u rebelua فَأَمَّا مَنْ طَغَى ۞<sup>(89)</sup>

1. Universi i ndërtuar nga Zoti i Madhërishtë është aq mbresëlënës dhe plot mrekulli, sa që krijimet e njeriut karshi tij janë krejtësisht të papërfillshme, qofshin ndërtimet e tij më të sofistikuara, si anijet kozmike, luftanijet, nëndetëset etj.. Po kështu, krijimi i vetë njeriut gjithashtu është kaq i habitshëm, që sa më shumë ta studiojmë atë, aq më shumë shpalosen përpara nesh shembuj të jashtëzakonshëm të mjeshtërisë së Allahut.

2. Për këtë kuptim të fjalës *mer'a*, shikoni fjalorin Mufredat Elfadhul-Kuran.

3. Ajetet 33-34: Ngulitja e maleve në tokë është përmendur sepse edhe jetesa e njerëzve dhe e kafshëve është e lidhur me malet, të cilat shërbejnë si magazina të ushqimeve dhe të ujit.

39. dhe i dha përparësi jetës së kësaj bote,

وَأَثَرِ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا ۝٣٩

40. pikërisht xhehenemi është streha e tij.

فَإِنَّ الْجَحِيمَ هِيَ الْمَأْوَىٰ ۝٤٠

41. Kurse ai që i frikësohet pozitës së Zotit të tij dhe e ndalon veten nga tundimi,

وَأَمَّا مَنْ خَافَ مَقَامَ رَبِّهِ وَنَهَى النَّفْسَ عَنِ الْهَوَىٰ ۝٤١

42. pikërisht xheneti është streha e tij.

فَإِنَّ الْجَنَّةَ هِيَ الْمَأْوَىٰ ۝٤٢

43. Ata të pyesin rreth Orës se kur do të bëhet ajo?

يَسْأَلُونَكَ عَنِ السَّاعَةِ أَيَّانَ مُرْسَاهَا ۝٤٣

44. Po ti, në çfarë mendimesh ke rënë nga përmendja e saj?

فِيمَ أَنْتَ مِنْ ذِكْرهَا ۝٤٤

45. Te Zoti yt është fundi i saj.

إِلَىٰ رَبِّكَ مُنْتَهَاهَا ۝٤٥

46. Ti mund të alarmosh vetëm atë që i frikësohet asaj.

إِنَّمَا أَنْتَ مُنذِرٌ مَّن يَخْشَاهَا ۝٤٦

47. Kur ata do ta shohin atë, do të mendojnë sikur kanë qëndruar (në këtë botë) vetëm një natë ose një mëngjes të saj.

كَأَنَّهُمْ يَوْمَ يَرَوْنَهَا لَمْ يَلْبَثُوا إِلَّا عَشِيَّةً  
بَعْضُ أَوْصَحِّهَا ۝٤٧

## Surja 80 – Abese

Surja Abese është zbritur në periudhën e hershme mekase dhe, bashkë me *bismillahin*, ka dyzet e tri ajete.

Edhe kjo sure përmend njërin nga mohuesit mendjemëdhenj të kohës së Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, i cili kishte ardhur për t'i bërë disa pyetje Profetit<sup>savs</sup>. Ngaqë Profeti<sup>savs</sup> donte shumë që njerëzit të udhëzoheshin, cilëndo qofshin ata, i kushtoi vëmendje me dhembshuri të madhe vizitorit në fjalë, pavarësisht nga mendjemadhësia e tij. Ndërkohë, një besimtar që ishte i verbër, erdhi për ta pyetur Profetin<sup>savs</sup> për diçka, por Profeti<sup>savs</sup> nuk e pëlqeu ndërhyrjen e tij. Megjithatë, pakënaqësinë e tij i shprehu me shenjë në atë mënyrë, që debatuesi mendjemadh mund ta shikonte atë, por jo besimtari i verbër, në mënyrë që ai të mos mërzitej.

Pas kësaj ngjarjeje, Allahu i Madhërishëm e porositi Profetin<sup>savs</sup> që të mos ishte i shkujdesur asnjëherë ndaj atij që i vjen me përkushtim dhe sinqeritet të madh, dhe të mos i jepte përparësi atij që është mendjemadh dhe që vjen për të hulumtuar, sado me ndikim të jetë ai, mbi atë që është i përkushtuar dhe i devotshëm, sado i varfër qoftë ai.

Më pas, shohim madhësitinë e Kuranit të Shenjtë sesi ky Libër zbulon sekretet e fazave të para të krijimit, gjithashtu edhe ngjarjet madhështore që do të ndodhin në fund, përpara Ditës së Kiametit.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Ngërtheu vetullat dhe e ktheu shpinën,

عَبَسَ وَتَوَلَّى ②

3. sepse atij i erdhi i verbri.

أَنْ جَاءَهُ الْأَعْيَى ③

4. E si mund të dije ti, ndoshta ai do të dëlirësohej?!

وَمَا يُدْرِيكَ لَعَلَّهُ يَزَّكَّى ④

5. ose të thellohej në këshillë, që këshilla t'i bënte dobi?!

أَوْ يَذَّكَّرُ فَتَنْفَعَهُ الذِّكْرَى ⑤

6. Kurse atij që u tregua shpërfillës,

أَمَّا مَنِ اسْتَعْتَى ⑥

7. ti i kushtove vëmendje.

فَأَنْتَ لَهُ تَصَدَّى ⑦

8. Ndërkohë që nuk ke përgjegjësi nëse ai nuk dëlirësohet.

وَمَا عَلَيْكَ أَلَّا يَزَّكَّى ⑧

9. Dhe ndaj atij që ty të erdhi me mundim,

وَأَمَّا مَنْ جَاءَكَ يَسْعَى ⑨

10. që edhe i frikësohej (Zotit),

وَهُوَ يَخْشَى ⑩

11. ti u tregove i pavëmendshëm!

فَأَنْتَ عَنْهُ تَلَهَّى ⑪

12. Kujdes! Kjo është një këshillë!

كَلَّا إِنَّهَا تَذْكِرَةٌ ⑫

13. Kush të dojë le ta mbajë në kujtesë.

فَمَنْ شَاءَ ذَكَرْهُ ⑬

14. (Kjo këshillë) është në skripte të ndëruara,

فِي صُحُفٍ مُّكَرَّمَةٍ ⑭

15. të lartësuar, të pastërta, مَرْفُوعَةً مُطَهَّرَةً ۞
16. në duart e shkruesve بِأَيْدِي سَفَرَةٍ ۞
17. shumë të nderuar e të dëlirë. كِرَامٍ بَرَرَةٍ ۞
18. E gjetë vdekjen njeriu për mosmirënjohjen që tregoi! قَتَلَ الْإِنْسَانَ مَا أَكْفَرَهُ ۞
19. (Allahu) prej çfarë e krijoi atë?! مِنْ أَيِّ شَيْءٍ خَلَقَهُ ۞
20. Prej sperme; e krijoi dhe e përsosi; مِنْ نُطْفَةٍ خَلَقَهُ فَقَدَّرَهُ ۞
21. më pas ia bëri të lehtë rrugën; ثُمَّ السَّبِيلَ يَسَّرَهُ ۞
22. më pas i dha vdekje dhe e varrosi;<sup>1</sup> ثُمَّ أَمَاتَهُ فَأَقْبَرَهُ ۞
23. pastaj, kur të dojë, do ta ngrrejë. ثُمَّ إِذَا شَاءَ أَنشَرَهُ ۞
24. Kujdes! (Njeriu) ende nuk e ka kryer porosinë që (Zoti) i dha. كَلَّا لَمَّا يَقْضِ مَا أَمَرَهُ ۞
25. Atëherë, njeriu le të shohë ushqimin e tij. فَلْيَنْظُرِ الْإِنْسَانُ إِلَى طَعَامِهِ ۞
26. Ne e lëshuam ujin bollshëm. أَنَّا صَبَبْنَا الْمَاءَ صَبًّا ۞
27. Më pas e çamë mirë tokën. ثُمَّ شَقَقْنَا الْأَرْضَ شَقًّا ۞
28. Bëmë të mbijnë drithëra në të, فَأَنْبَتْنَا فِيهَا حَبًّا ۞
29. rrush e perime, وَعِنَبًا وَقَضْبًا ۞

1. Ajeti nuk nënkupton që çdo njeri ka një varr të ndërtuar, pasi disa njerëz mbyten në ujë, disa bëhen pre e egërsirave etj.. Andaj, këtu varri nënkupton edhe periudhën e *berzahut*, e cila gjithashtu është një gjendje varri për njeriun, që fillon pas vdekjes së tij e vijon deri përpara ringjalljes. Pra, çdo shpirt do ta kalojë pashmangshmërisht edhe këtë periudhë. Lexoni edhe 23:101.



30. ullinj e hurma, وَرَيْتُونًا وَنَخْلًا ﴿٣٠﴾
31. pemishte të dendura, وَحَدَاقٍ عُلْبًا ﴿٣١﴾
32. fruta e barishte; وَأَفَاكِهِمْ وَأَبَّاءُ ﴿٣٢﴾
33. si mjete jetese për ju e për bagëtitë tuaja. مَتَاعًا لَّكُمْ وَلِأَنْعَامِكُمْ ﴿٣٣﴾
34. Andaj, kur do të vijë ulërima e madhe, فَإِذَا جَاءَتِ الصَّاحَةُ ﴿٣٤﴾
35. ditën kur njeriu do t'i ikë vëllait të tij, يَوْمَ يَفِرُّ الْمَرْءُ مِنْ أَخِيهِ ﴿٣٥﴾
36. nënës dhe babait të tij, وَأُمِّهِ وَأَبِيهِ ﴿٣٦﴾
37. gruas dhe fëmijës së tij. وَصَاحِبَتِهِ وَبَنِيهِ ﴿٣٧﴾
38. Çdo njeri nga ta, atë ditë do të ketë një hall që nuk do ta lejojë atë të mendojë për askënd. لِكُلِّ امْرِئٍ مِنْهُمْ يَوْمَئِذٍ شَأْنٌ يُغْنِيهِ ﴿٣٨﴾
39. Atë ditë disa fytyra do të jenë të ndritura, وَوُجُوهُ يَوْمَئِذٍ مُّسْفِرَةٌ ﴿٣٩﴾
40. të qeshura e të gëzuara. صَاحِكَةٌ مُّسْتَبْشِرَةٌ ﴿٤٠﴾
41. Po atë ditë disa fytyra do të jenë të pluhurosura, وَوُجُوهُ يَوْمَئِذٍ عَلَيْهَا غَبَرَةٌ ﴿٤١﴾
42. të pushtuara nga errësira. تَرَهَقْنَهَا قَتَرَةٌ ﴿٤٢﴾
43. Pikërisht këta janë mosmirë-njohësit, të ligjtë. ﴿٤٣﴾ أُولَئِكَ هُمُ الْكٰفِرَةُ الْفٰجِرَةُ ﴿٤٤﴾

## Surja 81 – Et-Tekvir

Surja Et-Tekvir është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka tridhjetë ajete.

Edhe një herë tjetër përmes kësaj sureje Kurani i Shenjtë parashikon ngjarje madhështore që do të ndodhnin në të ardhmen, të cilat do të ishin edhe dëshmi për ardhjen e Kiametit të madh.

Për dëshminë e parë, sjell diellin që është i mbuluar, dhe i referohet Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, pasi armiqtë e dritës shpirtërore të asaj kohe do ta pengojnë dritën e tij që ajo të mos përhapet mes njerëzimit. Pra, strategjitë dhe komplotet e tyre do të jenë ato që do ta mbulojnë këtë diell. Kjo do të jetë koha kur edhe drita e sahabëve (yjet) do të zbehet. Në mungesën e diellit, yjet janë ato që i udhëzojnë njerëzit deri diku me dritën e tyre, por kjo do të jetë koha kur njerëzit do ta humbasin edhe mundësinë e udhëzimit përmes sahabëve. Kjo është koha kur malet e mëdha do të lëvizin, që do të thotë se do të lundrojnë anijet madhështore dhe do të fluturojnë avionët gjigantë, mjete të cilat janë porsit malet për shkak të madhësisë së tyre. Dhe pikërisht për shkak të mjeteve të reja të transportit të kësaj epoke, devetë do të dalin jashtë përdorimit. Në këtë kohë do të hapen në çdo vend parqe të mëdha zoologjike.

Të gjithë e dimë që në kohën e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, profecitë e mësipërme as që mund të imagjinohej sesi do të përmbusheshin. Edhe parqet zoologjike të kohës sonë dëshmojnë faktin që grumbullimi i kafshëve të egra në një vend nuk mund të realizohej pa pasur mjete gjigante të transportit siç janë anijet dhe avionët që u përmendën më sipër, gjë që njeriu i kohës së Profetit<sup>savs</sup> as nuk mund ta përfytyronte dot.

Më pas, kjo sure ndoshta na tërheq vëmendjen te luftërat detare. Pra, kur anijet do të lundrojnë fuqishëm nëpër dete e oqeanë. Falë këtyre zhvillimeve, njerëzit e vendeve të largëta do të takohen me njëri-tjetrin. Pra, jo vetëm që do të grumbullohen kafshët, por edhe njerëzit. Kjo do të jetë koha e ligjit në shkallë botërore, dhe sundimi i ligjit do të jetë evident në atë mënyrë që njeriu nuk do të mund t'i bëjë padrejtësi as fëmijës së tij. Në dukje ligji do ta sundojë botën, por duke mohuar ligjin e Allahut të Madhërishëm, edhe ligji i sajuar i botës nuk do të arrijë të largojë trazira e çrregullime të ndonjë vendi.

Kjo do të jetë koha kur librat do të botohen e publikohen me shumicë. Kërkuesit e sekreteve të kozmosit, në njëfarë mënyre, do ta “zhveshin” qiellin me zbulimet e tyre. Në atë kohë xhehenemi do të flakërojë. Ky xhehenem do të jetë jo vetëm xhehenemi i ndëshkimeve që do ta kaplojnë botën, por edhe xhehenemi i luftërave që do t'i shkaktojnë vetë njerëzit. Por pavarësisht nga kjo, atyre që do të zbatojnë me sinqeritet mësimet e Allahut të Madhërishëm, do t'u afrohet xheneti. Çdo njeri do të kuptojë mirë se çfarë ka dërguar përpara ai për veten e tij.

Ajetet 16 – 17 sjellin dëshminë e disa anijeve luftarake që veprojnë fshehtas dhe

largohen për t'u fshehur në bazën e tyre. Kjo temë është përsëritur këtu sepse tregon që në atë kohë, idetë djallëzore do ta sulmojnë njeriun edhe në botën e tij shpirtërore, të cilat djalli dhe përfaqësuesit e tij do t'i përhapin dhe më pas fshihen. Më pas, kjo sure sjell për dëshmi natën, së cilës do t'i vijë fundi, dhe shenjat e agimit do të fillojnë të shfaqen. Përfundimisht, kjo natë e gjatë e errët, patjetër do të sjellë mëngjesin e Islamit.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.
2. Kur dielli të mbulohet.
3. Dhe kur yjet të zbehen.
4. Dhe kur malet të lëvizin.
5. Dhe kur devetë me barrë dhjetëmuajshe të braktisen.<sup>1</sup>
6. Dhe kur egërsirat të grumbullohen.
7. Dhe kur detet të derdhen fort njëri mbi tjetrin.<sup>2</sup>
8. Dhe kur njerëzit të bashkohen.<sup>3</sup>

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

إِذَا الشَّمْسُ كُوِّرَتْ ②

وَإِذَا النُّجُومُ انْكَدَرَتْ ③

وَإِذَا الْجِبَالُ سُيِّرَتْ ④

وَإِذَا الْعِشَارُ عُطِّلَتْ ⑤

وَإِذَا الْوُحُوشُ حُشِرَتْ ⑥

وَإِذَا الْبِحَارُ سُجِّرَتْ ⑦

وَإِذَا النُّفُوسُ زُوِّجَتْ ⑧

1. Edhe Profeti Muhammed<sup>savs</sup> duke parashikuar kohën e ardhjes së Mesihut të Premtuar, tha: “devetë do të braktisen dhe njerëzit nuk do të udhëtojnë më me to” (Muslimi, kitab “El-Iman”, bab “Nuzule Isa ibn Merjem ...”, hadithi 391). Pra, askush nuk do të udhëtojë me deve, që do të thotë se do të shpikëj një mjet tjetër transporti, si treni, vetura etj. Pse është përmendur deveja? Sepse pikërisht ajo ishte mjeti kryesor i arabëve për transport, me të cilin ata udhëtonin duke marrë edhe plaçkat e shtëpive të tyre të vogla. Dihet, nëse përmendet një kafshë e madhe bartëse si deveja, kafshët e tjera bartëse nënkuptohen vetë. Shkurt, profecia ishte se do të shpikeshin mjete të tilla të transportit, të cilat do t'i zëvendësojnë kafshët bartëse. A mund të ketë shenjë më të qartë se kjo! Kështu, edhe surja e Kuranit dhe hadithi i Profetit<sup>savs</sup> paralajmërojnë për të njëjtën kohë, kur do të shpikeshin mjetet e tjera të transportit, të cilat do ta zëvendësonin edhe devenë, dhe pikërisht ajo do të ishte koha e Imam Mehdiut dhe e Mesihut të Premtuar.

2. Me gërmimin e Kanalit të Suezit gjatë viteve 1859-1869, si dhe atë të Kanalit të Panamasë gjatë viteve 1903-1914, bota dëshmoi përbushjen edhe të kësaj profecie. Lexoni edhe 55:20-21; 25:54. Folja në arabisht “*suxh-xhuret*” që është përmendur në këtë ajet, sipas fjalorit “Lane”, mund të përkthehet në tri variante të mëposhtme: (1) Dhe kur detet do të vlojnë (2) Dhe kur detet do të derdhen fort njëri mbi tjetrin (3) Dhe kur deteve do t'u vihet zjarr. Realisht, profecia u përbush në të tria kuptimet e saj.

3. Njerëzit ose popujt do të bashkoheshin nëpërmjet lidhjeve (traktateve) të ndërsjella, siç ishte Liga e Kombeve dhe më pas Kombet e Bashkuara, dhe shumë organizata të tjera ndërkombëtare. Për më tepër, teknologjia jashtëzakonisht e avancuar në fushën e

9. Dhe kur (foshnja femër) e varrosur  
për së gjalli të pyetet,

وَإِذَا الْمَوْءِدَةُ سُئِلَتْ ۝٩

10. (se) për çfarë faji u vra ajo.<sup>4</sup>

يَايَ ذُنُوبٍ قُتِلَتْ ۝١٠

11. Dhe kur skriptet të përhapen.<sup>5</sup>

وَإِذَا الصُّحُفُ نُشِرَتْ ۝١١

12. Dhe kur qielli të zhvishet.<sup>6</sup>

وَإِذَا السَّمَاءُ كُشِطَتْ ۝١٢

13. Dhe kur xhehenemi të flakërojë.<sup>7</sup>

وَإِذَا الْجَحِيمُ سُعِرَتْ ۝١٣

14. Dhe kur xheneti të afrohet.<sup>8</sup>

وَإِذَا الْجَنَّةُ أُرْلِفَتْ ۝١٤

15. Njeriu do ta dijë se çfarë ka  
gatitur ai.

عَلِمَتْ نَفْسٌ مَّا أَحْضَرَتْ ۝١٥

16. Dëgjoni! Beto hem për ato që  
tërhiqen pasi të kenë përparuar  
fshehtas,

فَلَا أُقْسِمُ بِالْخُنُوسِ ۝١٦

17. (pra) për anijet që struken (në  
bazën e tyre)!

الْجَوَارِ الْكُنُوسِ ۝١٧

telekomunikacionit dhe rrjetet sociale në kohët e sotme, si të thuash, kanë rrëzuar çdo mur që mund të pengonte popuj të ndryshëm për të njohur njëri-tjetrin.

4. Këto ajete parashikojnë vendosjen e shteteve, të cilat do ta theksonin zbatimin e ligjit deri në atë masë që do t'i ndëshkonin edhe prindërit që u bëjnë padrejtësi fëmijëve të tyre. Këto ajete janë përmbushur deri në atë pikë që, sot prindërit edhe sikur të ushtrojnë forcë ndaj fëmijës së tyre, shteti ua merr fëmijën nën kujdesin e vet, e jo më të flitet për vrasjen e tij. Lexoni edhe parathënien e sures.

5. Ky ajet bën profeci për shpikjen e shtypit modern, pa të cilin dorëshkrimet nuk mund të publikoheshin në mënyrë aq të gjerë dhe as nuk mund të shpërndareshin. Veç kësaj, botimi kolosal i librave gjithashtu shënon një epokë të përhapjes së dijes, shkencës dhe hulumtimit.

6. Ajete flet për zhvillimin e shkencës së astronomisë. Qielli që do të ketë rrugë, në të cilin mesazherët do të mund të fluturojnë nga një vend në një vend tjetër. Do të jetë koha e propagandës ajrore, aq gjerë sa që njeriu do të mund të fluturojë me anë të krahëve të ajrit.

7. Zhvillimi material, sado masiv të jetë, nuk mund t'i sjellë asnjë dobi njeriut, nëse ai i realizon ambiciet materiale duke paguar si çmim për to pëlqimin e Zotit. Mendjemadhësia e njeriut do t'i krijojë tensione të tilla botërore, që medoemos përfundojnë në një ferr luftërash.

8. Profeti Muhammed<sup>savs</sup> tha: Në kohën e Imam Mehdiut edhe një sexhde e sinqertë do të jetë më e vlefshme sesa e gjithë bota dhe gjithçka që ka ajo. (Muslimi, kitab "El-Iman", bab "Nuzule Isa ibn Merjem ...", hadithi 392 (155)).

18. Dhe (betohem) për natën kur ajo mbaron!

وَاللَّيْلِ إِذَا عَسْعَسَ ۝١٨

19. Dhe për mëngjesin kur ai merr frymë!<sup>9</sup>

وَالصُّبْحِ إِذَا تَنَفَّسَ ۝١٩

20. Pa dyshim, kjo është fjalë e një të Dërguari të nderuar;

إِنَّهُ لَقَوْلُ رَسُولٍ كَرِيمٍ ۝٢٠

21. të fuqishëm (e) me pozitë të lartë pranë Zotëruesit të Arshit;

ذِي قُوَّةٍ عِنْدَ ذِي الْعَرْشِ مَكِينٍ ۝٢١

22. të bindur (dhe) të besueshëm atje (pra, pranë Zotëruesit të Arshit).

مُطَاعٍ ثَمَّ أَمِينٍ ۝٢٢

23. Shoku juaj nuk është i çmendur,

وَمَا صَاحِبُكُمْ بِمَجْنُونٍ ۝٢٣

24. ai e pa atë në horizontin e qartë.<sup>10</sup>

وَلَقَدْ رَآهُ بِالْأُفُقِ الْمُبِينِ ۝٢٤

25. Dhe ai nuk është koprrac për (të treguar) të padukshmen.

وَمَا هُوَ عَلَى الْغَيْبِ بِضَنِينٍ ۝٢٥

26. Dhe as ai (pra, Kurani) nuk është fjalë e ndonjë djalli të mallkuar.

وَمَا هُوَ بِقَوْلِ شَيْطَانٍ رَجِيمٍ ۝٢٦

27. Atëherë ku po largoheni ju?!

فَأَيْنَ تَذْهَبُونَ ۝٢٧

28. Ai është vetëm një këshillë për (të gjitha) botët;

إِنْ هُوَ إِلَّا ذِكْرٌ لِلْعَالَمِينَ ۝٢٨

29. për cilindo prej jush që dëshiron të jetë i qëndrueshëm.

لِمَنْ شَاءَ مِنْكُمْ أَنْ يَسْتَقِيمَ ۝٢٩

30. Dhe ju nuk mund të dëshironi dot, përveçse nëse dëshiron Allahu, Zoti i botëve.

وَمَا تَشَاءُونَ إِلَّا أَنْ يَشَاءَ اللَّهُ رَبُّ الْعَالَمِينَ ۝٣٠

9. Me ardhjen e Reformatorit të Ditëve të Mëvonshme do të fillojë të largohet nata e rënies morale dhe e degradimit të muslimanëve, duke hapur rrugën për agimin e një të ardhmeje të madhe dhe të lavdishme për Islam.

10. Ajetet 23 – 24 tregojnë që Profeti Muhammed<sup>savs</sup> nuk i thotë këto fjalë nga vetja, përkundrazi, ai me të vërtetë e ka parë Xhibrailin në horizontin e qartë.

## Surja 82 – El-Infitar

Surja El-Infitar është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka njëzet ajete.

Edhe kjo sure hapet me përmendjen e yjeve, jo më të zbehjes, por të rënies së tyre, duke treguar se njeriu do të privohet tërësisht nga drita e tyre, gjatë disa errësirave të natës. Më pas, duke përmendur detet, kjo sure pohon që jo vetëm që anijet do të lundrojnë me shumicë duke zbuluar sekretet e deteve dhe duke i çarë ato, madje edhe në tokë, pra në terik, do të punojnë arkeologët duke hapur varre të vjetra e duke zbuluar relikte të civilizimeve të lashta. Atë ditë njeriu do të mësojë se çfarë kanë bërë njerëzit e mëparshëm dhe se çfarë do të bëjnë të mëvonshmit në të ardhmen.

Në fund të kësaj sureje, edhe një herë përmendet Dita e Ahiretit. Një nga ajetet e fundit pohon se sundimtarët nuk e kanë sundimin, por sundimin e vërtetë edhe në këtë botë e ka Allahu i Madhërishëm, tek i cili do të kthehet çdo sundim në Ditën e Gjykimit, dhe sundimtarët tokësorë do të mbeten tërësisht të pagjeshëm.

Ajetet:  
20٨٢ سُورَةُ الْاِنْفِطَارِ  
82. EL-INFITAR  
MekaseRukutë:  
1

1. Me emrin e Allahut, të Gjithë-  
mëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ ①

2. Kur qielli të çahet.

اِذَا السَّمَاءُ اِنْفَطَرَتْ ①

3. Dhe kur yjet të bien.

وَاِذَا النُّجُوْمُ كُوِّبَتْ ①

4. Dhe kur detet të çahen.

وَاِذَا الْبِحَارُ فُجِّرَتْ ①

5. Dhe kur varret të zhvarrosen.

وَاِذَا الْقُبُوْرُ بُعْثِرَتْ ①

6. Çdo shpirt do të mësojë se çfarë ka  
çuar përpara dhe çfarë ka lënë pas.

عَلِمَتْ نَفْسٌ مَّا قَدَّمَتْ وَاٰخَرَتْ ①

7. O njeri! Çfarë të mashtroi ty në  
lidhje me Zotin tënd të Nderuar?<sup>1</sup>

يٰۤاَيُّهَا الْاِنْسٰنُ مَا غَرَّكَ بِرَبِّكَ الْكَرِیْمِ ①

8. I cili të krijoi, të drejtoi dhe të  
përsosi;

الَّذِیْ خَلَقَكَ فَسَوَّبَكَ فَعَدَلَكَ ①

9. në çfarëdo formë që deshi, të  
formoi.

فِیْ اٰیِّ صُوْرَةٍ مَّا شَاءَ رَكَّبَكَ ①

10. Kujdes! E vërteta është se  
Gjykimin ju e quajtët gënjeshtër.

كَلٰٓءَ بَلٌ تُكَدِّبُوْنَ بِالْاٰیٰتِ ①

11. Kurse mbi ju qëndrojnë  
mbikëqyrës,

وَ اِنَّ عَلَیْكُمْ لَحٰفِظِیْنَ ①

12. shkrues të nderuar;

كِرٰمًا كَاتِبِیْنَ ①

13. ata shkruajnë gjithçka që bëni.

یَعْلَمُوْنَ مَا تَفْعَلُوْنَ ①

1. Njeriu është kaq i zgjuar saqë e çoi në kulm zhvillimin material, duke zbuluar çdo sekret edhe në det, edhe në tokë, edhe në qiell. Por mjerisht, e vetmja gjë që i mbetet enigmë, është Zoti i Nderuar!



14. Sigurisht, mirëbërësit do të jenë në begati.

إِنَّ الْأَبْرَارَ لَفِي نَعِيمٍ ۝١٤

15. Dhe, sigurisht, të ligjtë do të jenë në xhehenem.

وَأِنَّ الْفَجَّارَ لَفِي جَحِيمٍ ۝١٥

16. Në të do të hidhen Ditën e Gjykimit.

يَصْلَوْنَهَا يَوْمَ الدِّينِ ۝١٦

17. Ata kurrësi nuk mund të mungojnë dot në të.

وَمَا هُمْ عَنْهَا بِغَائِبِينَ ۝١٧

18. E si mund ta dish ti se ç'është Dita e Gjykimit?

وَمَا أَدْرَاكَ مَا يَوْمَ الدِّينِ ۝١٨

19. Sërish, si mund ta dish ti se ç'është Dita e Gjykimit?

ثُمَّ مَا أَدْرَاكَ مَا يَوْمَ الدِّينِ ۝١٩

20. Ditën kur asnjë shpirt nuk do të ketë aspak fuqi për shpirtin tjetër, dhe vendimi atë ditë do të jetë i Allahut.

يَوْمَ لَا تَمْلِكُ نَفْسٌ لِّنَفْسٍ سِيًّا ۝٢٠  
وَالْأَمْرُ يَوْمَئِذٍ لِلَّهِ ۝٢١

## Surja 83 – El-Mutaffifin

Surja El-Mutaffifin është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka tridhjetë e shtatë ajete.

Kjo sure u tërheq njerëzve vëmendjen te peshorja duke thënë – Kurrresi nuk mund të keni sukses, derisa nuk do të bëni drejtësi. Nuk duhet të ndodhë që matjet tuaja të jenë ndryshe për të marrë, e ndryshe për të dhënë. Në këtë mënyrë, kjo sure zbërthen tregun e kohës së sotme. Popujt e pasur e të fuqishëm kurdoherë që bëjnë marrëveshje me popujt e varfër, ata që humbin përfundimisht nga këto marrëveshje, janë popujt e varfër. Kjo sure u tërheq vërejtjen të padrejtëve se pse nuk mendojnë që ka edhe një Ditë të Madhe të Gjykimit, kur ndër të tjera, do të gjykohen edhe pazaret e tyre që kanë bërë në këtë botë. Kjo është ajo Ditë e Gjykimit që u përmend në fund të sures paraardhëse.

Ajetet në vijim e shpjegojnë më tej temën e Ditës së Gjykimit, duke bërë paralajmërimin që mohuesit e saj janë shkatërruar edhe në të kaluarën dhe se edhe në epokën e të mëvonshmëve mohuesit e kësaj Dite do të kenë të njëjtin fund.

Më pas, duke bërë një krahasim mes banorëve të xhehenemit dhe atyre të xhenetit, kjo sure paralajmëron që atje besimtarët do të jenë ata që do t'i pyesin mohuesit për gjendjen e tyre dhe do të qeshin mbi ta, pasi mohuesit në jetën e kësaj bote i përqeshnin besimtarët dhe i poshtëronin në mënyra të ndryshme.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. U shkatërrrofshin ata që masin keq!

وَيْلٌ لِّلْمُطَفِّفِينَ ①

3. Të cilët kur matin për vete, e marrin të plotë.

الَّذِينَ إِذَا أَكْتَالُوا عَلَى النَّاسِ يَسْتَوْفُونَ ②

4. Ndërsa kur matin për të tjerët, ua japin të mangët.

وَإِذَا كَالُوهُمْ أَوْ وَزَنُوهُمْ يُخْسِرُونَ ③

5. Këta a nuk mendojnë se do të ringjallen

أَلَا يَظُنُّ أُولَئِكَ أَنَّهُمْ مَبْعُوثُونَ ④

6. për një Ditë Madhështore?!

لِيَوْمٍ عَظِيمٍ ⑤

7. Ditën kur njerëzit do të qëndrojnë përpara Zotit të botëve.

يَوْمَ يَقُومُ النَّاسُ لِرَبِّ الْعَالَمِينَ ⑥

8. Dëgjoni! Dosja e keqbërësve është në *sixh-xhin*.

كَلَّا إِنَّ كِتَابَ الْفُجَارِ لَفِي سِجِّينَ ⑦

9. E si mund ta dish ti se ç'është *sixh-xhini*?

وَمَا أَدْرَاكَ مَا سِجِّينَ ⑧

10. Është një libër i shkruar.

كِتَابٌ مَّرْقُومٌ ⑨

11. U shkatërrrofshin atë ditë mohuesit,

وَيْلٌ يَوْمَذِي الْقَعْدِ لِلْمُكَذِّبِينَ ⑩

12. të cilët Ditën e Gjykimit e quajnë gënjeshtër!

الَّذِينَ يَكْذِبُونَ بِيَوْمِ الدِّينِ ⑪

13. Dhe atë askush nuk e quan gënjeshtër, përveçse ai që e tepron (dhe) është mëkatar i madh.

وَمَا يَكْذِبُ بِهِ إِلَّا كُلُّ مُعْتَدٍ أَثِيمٍ ⑫

14. Kur atij i lexohen ajetet Tona, thotë: “Janë përrallat e të parëve!”

إِذَا تُتْلَىٰ عَلَيْهِ آيَاتُنَا قَالَ أَسَاطِيرُ الْأَوَّلِينَ ﴿١٤﴾

15. Përkundrazi! Ua kanë ndryshkur zemrat punët që bënin.

كَلَّا بَلْ سَوَّاهُ رَانَ عَلَىٰ قُلُوبِهِمْ مَا كَانُوا يَكْسِبُونَ ﴿١٥﴾

16. Dëgjoni! Atë ditë ata do të jenë në perde ndarëse nga Zoti i tyre.<sup>1</sup>

كَلَّا إِنَّهُمْ عَنْ رَبِّهِمْ يَوْمَئِذٍ لَمَحْجُوبُونَ ﴿١٦﴾

17. Më pas do të hidhen në xhehenem.

ثُمَّ إِنَّهُمْ لَصَالُوا الْجَحِيمِ ﴿١٧﴾

18. Më pas do t’u thuhet: “Kjo është ajo që e quanit gënjeshtër!”

ثُمَّ يُقَالُ هَذَا الَّذِي كُنْتُمْ بِهِ تُكَذِّبُونَ ﴿١٨﴾

19. Dëgjoni! Dosja e mirëbërësve do të jetë në *il-lijjun*.

كَلَّا إِنَّ كِتَابَ الْأَبْرَارِ لَفِي عِلِّيِّينَ ﴿١٩﴾

20. E si mund ta dish ti se ç’është *il-lijjun*?

وَمَا آذْرَبِكَ مَا عِلِّيُّونَ ﴿٢٠﴾

21. Është një libër i shkruar.

كِتَابٌ مَّرْقُومٌ ﴿٢١﴾

22. Të cilin do ta shohin të afruarit (me Zotin).

يَشْهَدُهُ الْمُقَرَّبُونَ ﴿٢٢﴾

23. Pa dyshim, mirëbërësit do të jenë në begati,

إِنَّ الْأَبْرَارَ لَفِي نَعِيمٍ ﴿٢٣﴾

24. duke parë nga frone të zbuku-ruara.

عَلَى الْأَرْآئِكِ يَنْظُرُونَ ﴿٢٤﴾

25. Ti që në fytyrat e tyre do ta dallosh freskinë e begative.

تَعْرِفُ فِي وُجُوهِهِمْ نَضْرَةَ النَّعِيمِ ﴿٢٥﴾

1. Zoti nuk u pranon njerëzve veprat e pasinqerta. Pikërisht veprat e pasinqerta të tyre ua ndryshkin zemrat, dhe për këtë arsye, ata nuk do të jenë në gjendje ta shohin Zotin.

26. Do t'u jepet për të pirë një pije e vulosur.

يُسْقَوْنَ مِنْ رَحِيقٍ مَّحْوُورٍ ﴿٢٦﴾

27. Vula e saj do të jetë myshk. Dhe pikërisht për këtë le të garojnë ata që dëshirojnë.

خِلْمَهُ مِسْكَ ۖ وَفِي ذَلِكَ فَلْيَتَنَافَسِ  
الْمُتَنَافِسُونَ ﴿٢٧﴾

28. Shija e saj do të jetë (e përzier) me *tesnimin*.<sup>2</sup>

وَمَرَاةٌ مِنْ تَسْنِيمٍ ﴿٢٨﴾

29. (Ai) është një burim ku do të pinë të afruarit (me Zotin).

عَيْنًا يَشْرَبُ بِهَا الْمُقَرَّبُونَ ﴿٢٩﴾

30. Sigurisht, ata që kanë bërë mëkate, qeshnin ndaj atyre që besuan.

إِنَّ الَّذِينَ أَجْرَمُوا كَانُوا مِنَ الَّذِينَ آمَنُوا  
يَصْحَكُونَ ﴿٣٠﴾

31. Kur kalonin pranë tyre, i bënin me shenjë njëri-tjetrit.

وَإِذَا مَرُّوا بِهِمْ يَتَغَامَرُونَ ﴿٣١﴾

32. Kur ktheheshin në familjet e tyre, bënin shaka (për ta).

وَإِذَا انْقَلَبُوا إِلَىٰ أَهْلِهِمْ انْقَلَبُوا  
فَكِهِينَ ﴿٣٢﴾

33. Dhe kur i shikonin, thoshin: "Pikërisht këta janë të humburit!"

وَإِذَا رَأَوْهُمْ قَالُوا إِنَّ هَٰؤُلَاءِ لَضَالُّونَ ﴿٣٣﴾

34. Ndërkohë, ata nuk ishin dërguar si mbikëqyrës për ta.

وَمَا أَرْسَلْنَا عَلَيْهِمْ حَفِظِينَ ﴿٣٤﴾

35. Andaj, sot ata që besuan do të qeshin me mohuesit,

فَأَيُّومَ الَّذِينَ آمَنُوا مِنَ الْكُفَّارِ يَصْحَكُونَ ﴿٣٥﴾

36. duke parë nga frone të zbukuruara.

عَلَى الْأَرَائِكِ ۖ لَا يَنْظُرُونَ ﴿٣٦﴾

37. A janë shpërblyer plotësisht mohuesit për atë që bënin?!

هَلْ نُؤْتِبَ الْكُفَّارَ مَا كَانُوا يَفْعَلُونَ ﴿٣٧﴾

2. Sipas fjalorit *tesnim* nënkupton madhështinë. Andaj, shija e përzier me *tesnim* do të thotë, sa më shumë që banorët e xhenetit e shijojnë këtë pije, aq më shumë do të lartësohen në grada.

## Surja 84 – El-Inshikak

Surja El-Inshikak është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka njëzet e gjashtë ajete.

Duke vijuar shpjegimin e sureve të mëparshme në aspektin e profecive, edhe në këtë sure gjejmë parashikime për ngjarje të mëdha që do të ndodhnin në botë, ngjarje të cilat do të shërbenin edhe si provë se Dita e Gjykimit do të bëhet pashmangshmërisht. Edhe një herë tjetër vjen profecia e çarjes së qiellit, një kuptim i së cilës është që botën do ta pushtojnë katastrofa nga më të çuditshmet.

Më pas vjen profecia e zgjerimit të tokës. Ndonëse toka nuk duket e zgjeruar në kuptimin fizik të fjalës, por gjatë kohës së zbritjes së Kuranit të Shenjtë, njeriu kishte njohur vetëm gjysmën e botës, dhe gjysma tjetër do të zbulohet me zbulimin e Amerikës dhe të vendeve të tjera. Pra, në kuptimin figurativ, toka u zgjerua. Kjo do të ishte koha, kur toka do të nxirrte përjashta sekretet e saj një nga një, si të thuash, që të zbrazej me shumicë. Kjo epokë e zhvillimit të shkencës historikisht filloi me zbulimin e Amerikës.

Pas kësaj, ka një profeci për muslimanët që tregon se dita e tyre do të kalojë në errësira të ndryshme, gjersa nata do ta pushtojë botën, dhe atëherë do të lindë hëna e Islamit. Vetëm pastaj ata do të kapërcejnë shkallë-shkallë fazat e përparimit të tyre.

Ajetet:  
26

٨٤ سُورَةُ الْاِنْشِقَاقِ  
84. EL-INSHIKAK  
Mekase

Rukutë:  
1

1. Me emrin e Allahut, të Gjithë-  
mëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ١

2. Kur qielli të çahet,

إِذَا السَّمَاءُ انشَقَّتْ ٢

3. dhe t'i vërë veshin Zotit të tij, dhe  
kjo për të është obligim.

وَأَذِنَتْ لِرَبِّهَا وَحُقَّتْ ٣

4. Dhe kur toka të zgjerohet,

وَإِذَا الْأَرْضُ مُدَّتْ ٤

5. dhe të nxjerrë përjashta gjithçka  
që ka brenda, dhe të zbrazet,

وَأَلْقَتْ مَا فِيهَا وَتَخَلَّتْ ٥

6. dhe t'i vërë veshin Zotit të saj, dhe  
kjo për të është obligim.

وَأَذِنَتْ لِرَبِّهَا وَحُقَّتْ ٦

7. O njeri! Ti patjetër do të  
mundohesh shumë për (të shkuar)  
te Zoti yt; dhe (përfundimisht) do ta  
takosh Atë.

يَأْيُهَا الْإِنْسَانُ إِنَّكَ كَادِحٌ إِلَىٰ رَبِّكَ  
كَدْحًا فَمَلِّقِيهِ ٧

8. Atëherë, atij që do t'i jepet libri i  
tij në dorën e djathtë,

فَأَمَّا مَنْ أُوْتِيَ كِتَابَهُ بِيَمِينِهِ ٨

9. do t'i kërkohet një llogari e lehtë,

فَسَوْفَ يُحَاسَبُ حِسَابًا يَسِيرًا ٩

10. dhe ai do të kthehet i gëzuar te  
familja e tij.

وَيَقْلِبُ إِلَىٰ أَهْلِهِ مَسْرُورًا ١٠

11. Kurse atij që do t'i jepet libri i tij  
mbrapa shpine,

وَأَمَّا مَنْ أُوْتِيَ كِتَابَهُ وَرَاءَ ظَهْرِهِ ١١

12. ai do të lutet të shkatërrohet,

فَسَوْفَ يَدْعُوا ثُبُورًا ١٢

13. dhe do të hidhet në zjarrin  
flakërues;

وَيَصِلَىٰ سَعِيرًا ١٣

14. dikur ishte i gëzuar (kur ishte) në familjen e tij;

إِنَّهُ كَانَ فِي أَهْلِهِ مَسْرُورًا ۝١٤

15. mendonte se kurrë nuk do të ringjallej.<sup>1</sup>

إِنَّهُ ظَنَّ أَنْ لَنْ يَحُورَ ۝١٥

16. Përkundrazi! Zoti i tij gjithmonë e sheh mirë atë.

بَلَىٰ إِنَّ رَبَّهُ كَانَ بِهِ بَصِيرًا ۝١٦

17. Dëgjoni! Beto hem për muzgun e mbrëmjes!

فَلَا أَقْسِمُ بِالشَّفَقِ ۝١٧

18. Dhe për natën, si dhe për atë që ajo e pushton!

وَاللَّيْلِ وَمَا وَسَقَ ۝١٨

19. Dhe për hënën kur ajo bëhet e plotë!<sup>2</sup>

وَالْقَمَرِ إِذَا اتَّسَقَ ۝١٩

20. Ju patjetër do të përparoni shkallë-shkallë.<sup>3</sup>

لَتَرْكَبُنَّ طَبَقًا عَنْ طَبِقٍ ۝٢٠

21. Atëherë, çfarë u ndodhi që nuk besojnë?!

فَمَا لَهُمْ لَا يُؤْمِنُونَ ۝٢١

1. Një kuptim i fjalës *len jehure* është *len jub'athe* (d.m.th. *kurrë nuk do të ringjallet*). Shikoni fjalorin “Mufredat Elfadhul-Kuran”.

2. Folja *itteseka* do të thotë hëna e plotë nga nata e 13-të, deri në natën e 16-të (Shevkani, “Fet’hul-Kadir”, kom. i ajetit 84:18). Kjo është një shenjë që tregon se pas periudhës së errët, të cilën Profeti<sup>savs</sup> e quajti “*epokë shtrembërish*”, Islami do të fillojë të përparojë në shekullin e 13-të të tij, për të kulmuar deri në shekullin e 16-të. Më shumë për këtë temë, lexoni 32:6.

3. Ajetet 17 – 20: Në këto ajete betimi shoqërohet me fjalët “*fela*”, që nuk është “*la*” mohuese [ka shumë ajete të tjera në Kuranin e Shenjtë që paraqesin betimin po në këtë formë, për shembull, 69:39, 70:41 etj.]. Një kuptim i këtij lloji betimi është edhe mohimi i idesë së njerëzve të kohës kur është bërë betimi. Kështu që, në këtë ajet, Allahu i Madhërisëm e sjell si dëshmitar muzgun e mbrëmjes, më pas edhe procesin e errësimit të natës, dhe thotë se edhe në atë kohë, Ai nuk i lë njerëzit tërësisht në errësi, por dërgon hënën që ajo të reflektojë dritën e diellit. Gjithashtu, këto ajete tregojnë që edhe hëna nuk shfaqet përnjëherë me dritën e saj të plotë, por kalon procesin e saj për t’u bërë hëna e plotë e natës së katërbëdhjetë. Kjo tregon se pas dritës Profetike të Islamit, gjatë natës së rënies së muslimanëve, zinxhiri i *muxheddidëve* do të zgjatej deri në trembëdhjetë shekuj, dhe se pas këtij *zhvillimi shkallë-shkallë*, vetëm në shekullin e katërbëdhjetë do të shfaqej *muxheddidi* që do të simbolizonte hënën e plotë, pra Imam Mehdiu dhe Mesihu i Premtuar.



22. Kur u lexohet Kurani, nuk bien në sexhde?!  
 23. Madje, ata që mohuan, (e) quajnë gënjeshtër.

وَإِذَا قُرِئَ عَلَيْهِمُ الْقُرْآنُ لَا يَسْجُدُونَ ﴿١١﴾

بَلِ الَّذِينَ كَفَرُوا يَكْذِبُونَ ﴿١٢﴾

24. Dhe Allahu e di më së miri se çfarë grumbullojnë ata.

وَاللَّهُ أَعْلَمُ بِمَا يُوعُونَ ﴿١٣﴾

25. Atëherë, jepu “lajmin e mirë” për një ndëshkim të dhimbshëm!

فَبَشِّرْهُمْ بِعَذَابٍ أَلِيمٍ ﴿١٤﴾

26. Por jo atyre që besuan dhe bënë të mira; ata do të kenë shpërblim pambarim.

إِلَّا الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَهُمْ أَجْرٌ غَيْرُ مَمْنُونٍ ﴿١٥﴾

## Surja 85 – El-Buruxh

Surja El-Buruxh është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka njëzet e tri ajete.

Një lidhje e kësaj sureje me suren paraardhëse është që aty është përmendur rilindja e Islamit përmes lindjes së hënës, kurse këtu janë dhënë disa detaje për kohën kur do të ndodhë kjo ngjarje dhe se cili është qëllimi saj.

Yjësitë e qiellit janë dymbëdhjetë. Ato simbolizojnë dymbëdhjetë shekuj pas Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, dhe tregojnë se pas kësaj periudhe do të përmbushet kjo profeci. Ashtu siç hëna bëhet dëshmitare e diellit, në të njëjtën mënyrë, do të vijë një Dëshmitar për të dëshmuar madhësitinë e të Dëshmuarit të tij, pra, madhësitinë e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>. Në këtë dëshmim do të marrin pjesë edhe ndjekësit e tij të sinqertë, por këta do të persekutohen mizorisht e barbarisht, madje do të hidhen edhe në zjarr, ndërkohë materialistët do t'i bëjnë vetëm sehir kësaj makabre. Faji i tyre i vetëm do të jetë pranimi i Dëshmitarit që ka ardhur prej Zotit. Ky përshkrim është një skicë e qartë e gjithë asaj që po u bëhet vazhdimisht muslimanëve ahmedianë në Pakistan.

Në fund të kësaj sureje, Zoti i Madhërishëm u bën thirrje të fortë persekutuesve duke thënë: Edhe popujt e mëparshëm kur bënë mizori të tilla, ranë vetë në gropën e mizorive të tyre; andaj, betohem për Kuranin që është në Pllakën e Ruajtur, edhe ju do të ndëshkoheni për mizoritë tuaja!



1. Me emrin e Allahut, të Gjithë-mëshirshmit, Mëshirëbërësit. بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①
2. Betohem për qiellin me yjësi! وَالسَّمَاءِ ذَاتِ الْبُرُوجِ ①
3. Dhe për Ditën e Premtuar! وَالْيَوْمِ الْمَوْعُودِ ①
4. Dhe për Dëshmitarin, e për të Dëshmuarin! وَشَاهِدٍ وَمَشْهُودٍ ①
5. U shkatërrofshin njerëzit e hendekut!<sup>1</sup> قَتَلَ أَصْحَابَ الْأَحْدُودِ ①
6. (Pra, njerëzit) e atij zjarri që është me plot lëndë djegëse! النَّارِ ذَاتِ الْوَقُودِ ①
7. Kur ata do të rrinë ulur rreth tij!<sup>2</sup> إِذْ هُمْ عَلَيْهَا قُعُودٌ ①

1. Disa komentues të Kuranit pohojnë se këto ajete flasin për persekutimin me djegie deri në vdekje të disa të krishterëve nga mbreti hebre Dhu Nuvas i Jemenit. Disa të tjerë mendojnë se flitet për hedhjen në furrë të disa prijësve izraelitë nga mbreti Nabukadnetsar i Babilonisë (Bibla, Danieli 3:19-22). Realisht, këto ajete mund të aplikohen për të gjithë armiqtë e së vërtetës, të cilët në kohën e çdo Profeti të Zotit, i kundërshtojnë dhe i persekutojnë besimtarët. Së dyti, nuk duket që këto ajete t'u referohen ngjarjeve që paraqesin komentuesit në përgjithësi, pasi ato nuk kanë autenticitet të fortë. Po kështu, askund në Kuran, Zoti nuk është betuar për incidentet e kaluara. Së treti, në ajetin nr. 3, Zoti betohet për "Ditën e Premtuar". Andaj, një kuptim tjetër i këtyre ajeteve është që muslimanët duhet të kenë parasysh se si çdo herë, edhe ndjekësit e Mesihut të Premtuar do të përballen me persekutimet e ashpra që do t'ua bëjnë kundërshtarët e tyre. Përveç asaj që ndodhi në të kaluarën, këto ajete janë edhe profeci që një ngjarje e tillë do të ndodhte edhe në të ardhmen, në kohën e Mesihut të Premtuar. Sot fjalë për fjalë kjo është ajo që u ndodh muslimanëve ahmedianë në disa shtete, ku persekutuesit tentojnë t'i djegin për së gjalli ahmedianët. Fjalët "rrinë ulur" tregojnë që edhe të tjerët do t'i bëjnë vetëm sehir kësaj makabreje dhe nuk do të marrin asnjë masë për ta ndalur dhunën. Kjo profeci e madhe shumë herë është përmbushur ndaj muslimanëve ahmedianë, kur ata janë bërë pre e persekutuesve nën mbikëqyrjen e efektivave të policisë së atyre shteteve. Shumë herë persekutuesit e arritën qëllimin e tyre për të djegur ahmedianët, dhe shumë herë edhe dështuan.

2. Në ajetet 5-9 përmenden ata armiq të së vërtetës që ndezin zjarrin e persekutimit kundër besimtarëve të drejtë në të gjitha epokat, dhe që e mbajnë të ndezur atë. Fundi i tyre parashikohet në ajetin nr. 11.

8. Dhe do të jenë dëshmitarë të asaj që do të bëjnë me besimtarët.<sup>3</sup>

وَهُمْ عَلَىٰ مَا يَفْعَلُونَ بِالْمُؤْمِنِينَ شُهُودٌ ۝٨

9. Ata i urrejnë vetëm për arsye se këta e besuan Allahun, Mbizotëruesin, të Lavdishmin,

وَمَا نَقَمُوا مِنْهُمْ إِلَّا أَنْ يُؤْمِنُوا بِاللَّهِ الْعَزِيزِ الْحَمِيدِ ۝٩

10. i cili ka sundimin e qiejve dhe të tokës. Dhe Allahu është Dëshmitari i çdo gjëje.

الَّذِي لَهُ مُلْكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ۝ وَاللَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ شَهِيدٌ ۝١٠

11. Pa dyshim, ata që persekutuan besimtarët e besimtarët, më pas nuk u penduan, do të kenë ndëshkimin e xhehenemit, dhe do të kenë ndëshkimin e zjarrit.

إِنَّ الَّذِينَ فَتَنُوا الْمُؤْمِنِينَ وَالْمُؤْمِنَاتِ ۝ ثُمَّ لَمْ يَتُوبُوا فَلَهُمْ عَذَابُ جَهَنَّمَ وَلَهُمْ عَذَابُ الْحَرِيقِ ۝١١

12. Pa dyshim, ata që besuan dhe bënë të mira, do të kenë xhenete nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Ky është suksezi madhështor.

إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَهُمْ جَنَّاتٌ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ ۝ ذَلِكَ الْفَوْزُ الْكَبِيرُ ۝١٢

13. Njëmend, kapja e Zotit tënd është shumë e fortë.

إِنَّ بَطْشَ رَبِّكَ لَشَدِيدٌ ۝١٣

14. Sigurisht, Ai nis (krijimin) dhe e përsërit.

إِنَّهُ هُوَ بَدِئُ وَيَعِيدُ ۝١٤

15. Dhe pikërisht Ai është Falësi, Dashuruesi i Madh,

وَهُوَ الْعَفُورُ الْوَدُودُ ۝١٥

16. Zotëruesi i Arshit, i Lavdishmi.

ذُو الْعَرْشِ الْمَجِيدُ ۝١٦

17. Bërësi i gjithçkaje që do.

فَعَّالٌ لِمَا يُرِيدُ ۝١٧

18. A të erdhi lajmi i ushtrive?

هَلْ أَتَاكَ حَدِيثُ الْجُنُودِ ۝١٨

3. Armiqtë e së vërtetës janë të vetëdijshëm se kundërshtimi i tyre është mizor dhe i padrejtë dhe se viktimat e tiranisë së tyre janë të pafajshëm.

19. I Faraonit dhe i themudëve?

فِرْعَوْنَ وَثَمُودَ ﴿١٩﴾

20. Por ata që mohuan, rrinë vetëm duke quajtur gënjeshtër (të vërtetën).

بَلِ الَّذِينَ كَفَرُوا فِي تَكْذِيبٍ ﴿٢٠﴾

21. Kurse Allahu i ka rrethuar anepërqark.

وَاللَّهُ مِنْ وَرَائِهِمْ مُحِيطٌ ﴿٢١﴾

22. Por ky është një Kuran i lavdishëm,

بَلْ هُوَ قُرْآنٌ مَجِيدٌ ﴿٢٢﴾

23. në pllakën e ruajtur.

﴿٢٣﴾ فِي لَوْحٍ مَحْفُوظٍ

## Surja 86 – Et-Tarik

Surja Et-Tarik është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka tetëmbëdhjetë ajete.

Edhe kjo sure vijon temën e sures paraardhëse, pra të sures El-Buruxh, sepse bën profeci që gjatë natës së errët, Allahu i Madhërishëm cakton mbrojtës të Tij qiellorë, të cilët u vijnë në ndihmë robërve të Tij të pambrojtur. Vallë, njeriu pse nuk mendon që ai është një gjallesë që vetëm mburret e flet fjalë boshe?! Andaj, përfundimisht njeriu i tillë do të ndëshkohet për shkak të veprave të tij. Kurse duke iu drejtuar Profetit Muhammed<sup>savs</sup> dhe ndjekësve të tij të kësaj epoke, Zoti u thotë – Mizorët lërin të bëjnë mizori edhe pak kohë, sepse në fund do të kapen dhe do të ndëshkohen; andaj, prisni dhe jepuni pak afat!



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit. بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①
2. Beto hem për qiellin dhe për atë që del gjatë natës! وَالسَّمَاءِ وَالطَّارِقِ ②
3. E si mund ta dish ti se ç'është ai që del gjatë natës? وَمَا أَدْرَاكَ مَا الطَّارِقُ ③
4. Ylli i ndritshëm. النَّجْمِ الثَّاقِبِ ④
5. Nuk ka shpirt për të cilin të mos jetë caktuar një mbrojtës. إِنْ كُلُّ نَفْسٍ لَّمَّا عَلَيْهَا حَافِظٌ ⑤
6. Andaj, njeriu le të shohë se me se është krijuar? فَلْيَنْظُرِ الْإِنْسَانُ مِمَّ خُلِقَ ⑥
7. Është krijuar me një ujë që përhidhet. خُلِقَ مِنْ مَّاءٍ دَافِقٍ ⑦
8. Del përmes shpinës dhe brinjëve. يَخْرُجُ مِنْ بَيْنِ الصُّلْبِ وَالتَّرَائِبِ ⑧
9. Sigurisht, Ai është i Fuqishëm ta kthejë atë. إِنَّهُ عَلَى رَجْعِهِ لَقَادِرٌ ⑨
10. Ditën kur do të zbulohen sekretet. يَوْمَ تُبْلَى السَّرَائِرُ ⑩
11. Atëherë (njeriu) nuk do të ketë as fuqi, e as ndihmës. فَمَا لَهُ مِنْ قُوَّةٍ وَلَا نَاصِرٍ ⑪
12. Beto hem për qiellin që lëshon shi pas shiu!<sup>1</sup> وَالسَّمَاءِ ذَاتِ الرَّجْعِ ⑫

1. Fjala *er-rexh'u* do të thotë shi pas shiu. (Akrabul-Mevarid).

13. Për tokën që gjelbëron!<sup>2</sup> وَالْأَرْضِ ذَاتِ الصَّدْعِ ۝
14. Pa dyshim, kjo është fjalë vendimtare, إِنَّهُ لَقَوْلٌ فَصْلٌ ۝
15. dhe jo e kotë. وَمَا هُوَ بِالْهَزْلِ ۝
16. Ata bëjnë strategji. إِنَّهُمْ يَكِيدُونَ كَيْدًا ۝
17. Edhe Unë bëj strategji. وَأَكِيدُ كَيْدًا ۝
18. Andaj, jepu lëshim mohuesve. فَمَهْلِكِ الْكَافِرِينَ أَمْهَلُهُمْ رُؤْيَا ۝
- Jepu lëshim deri në një kohë.

2. Fjala *es-sad'u* do të thotë gjelbërim i tokës. (Akrabul-Mevarid).



## Surja 87 – El-A'la

Surja El-A'la është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka njëzet ajete.

Kjo sure që në fillim jep lajmin e mirë se emri i Allahut dhe emri i njerëzve të Tij do të triumfojnë. Këshilla për ju është të vazhdoni të këshilloni, sepse këshilla përfundimisht do të sjellë dobi, edhe nëse nuk duket e tillë në fillim. Më pas, duke iu drejtuar njeriut, Zoti thotë: Ti nuk përfiton nga këshilla, sepse i ke dhënë përparësi jetës së kësaj bote materiale mbi jetën e përtejme, ndërkohë, e fundit është e mbarë dhe e qëndrueshme.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Përmende shenjtërinë e emrit të Zotit tënd të Lartësuar,

سَبِّحْ اسْمَ رَبِّكَ الْأَعْلَى ①

3. që krijoi dhe rregulloi;

الَّذِي خَلَقَ فَسَوَّى ①

4. që përcaktoi (elementët), më pas udhëzoi;

وَالَّذِي قَدَّرَ فَهَدَى ①

5. dhe që nxori gjelbërimin për të mbrojtur jetën.<sup>1</sup>

وَالَّذِي أَخْرَجَ الْمَرْعَى ①

6. Më pas, (për mosmirënjohësit) atë e bëri byk të zi.

فَجَعَلَهُ غُثَاءً أَحْوَى ①

7. Ne do të të mësojmë ty (Kuranin), që ti nuk do ta harrosh.

سُنُقِرُنَاكَ فَلَا تَنْسَى ①

8. Përveç asaj që do Allahu.<sup>2</sup> Sigurisht, Ai e di të hapurën dhe të fshehtën.

إِلَّا مَا شَاءَ اللَّهُ ① إِنَّهُ يَعْلَمُ الْجَهْرَ وَمَا يَخْفَى ①

9. Dhe Ne do të të mundësojmë ty lehtësinë.

وَنُيَسِّرُكَ لِلْيُسْرَى ①

10. Andaj, këshillo! Këshilla patjetër sjell dobi.

فَذَكِّرْ ① إِنَّ نَفْعَتِ الذِّكْرِى ①

1. Për këtë kuptim të fjalës *mer'a*, shikoni fjalorin *Mufredat* i Imam Ragibit<sup>ra</sup>.

2. Ajetet 7 – 8: Harresa që është përmendur këtu nuk ka të bëjë me idenë se Profeti<sup>savs</sup> gjoja e harronte tërësisht Kuranin, por i referohet harresës njerëzore që mund t'i ndodhte atij dhe kujt do tjetër, duke e recituar Kuranin gjatë namazit. Dhe për këtë, Islami porositi që nëse imami që drejton namazin harron ndonjë fjalë të Kuranit, ndonjë nga besimtarët që qëndrojnë mbrapa, t'ia kujtojë atij.

11. Do ta pranojë këshillën ai që frikësohet.

سَيَذَكَّرُ مَنْ يَخْشَى ۝١١

12. Dhe do ta shmangë atë fatligu i madh,

وَيَتَجَنَّبُهَا الْأَشْقَى ۝١٢

13. i cili do të hidhet në zjarrin më të madh.

الَّذِي يَصِلَى النَّارَ الْكُبْرَى ۝١٣

14. Më pas, atje ai as nuk do të vdesë, e as nuk do të jetojë.

ثُمَّ لَا يَمُوتُ فِيهَا وَلَا يَحْيَى ۝١٤

15. Pa dyshim, fitoi ai që u pastrua,

قَدْ أَفْلَحَ مَنْ تَزَكَّى ۝١٥

16. përmendi emrin e Zotit të tij dhe u fal.

وَذَكَرَ اسْمَ رَبِّهِ فَصَلَّى ۝١٦

17. Por ju i jepni përparësi jetës së kësaj bote,

بَلْ تُؤْثِرُونَ الْحَيَاةَ الدُّنْيَا ۝١٧

18. kurse *ahireti* është më i miri dhe më i qëndrueshmi.

وَالْآخِرَةَ خَيْرٌ وَ أَبْقَى ۝١٨

19. Kjo është edhe në skriptet e para.

إِنَّ هَذَا لَفِي الصُّحُفِ الْأُولَى ۝١٩

20. Në skriptet e Ibrahimit dhe të Musait.<sup>3</sup>

فِي صُحُفِ إِبْرَاهِيمَ وَمُوسَى ۝٢٠

3. Ajetet 19 – 20: Zoti i Madhërishëm thotë se Kurani i Shenjtë ka përmbledhur mësimet e të gjitha skripteve të shenjta të mëparshme. Ka marrë mësimet më të mira edhe nga skriptet e Hazret Ibrahimit<sup>as</sup>, edhe nga skriptet e Hazret Musait<sup>as</sup>.

## Surja 88 – El-Gashije

Surja El-Gashije është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka njëzet e shtatë ajete.

Kjo sure përmend disa ndëshkime që do të vijnë vazhdimisht dhe që do të pushtojnë botën. Fytyrat atë ditë do të jenë të frikësuar dhe të rraskapitura. Ata do të hidhen në zjarrin flakërues, ku ushqimi i tyre do të jetë vetëm ferra dhe gjemba të hidhura, të cilat as nuk do t'i shëndoshin, e as nuk do t'ua shuajnë urinë.

Në ajetet në vijim, kjo sure përshkruan atë që do të ndodhë në botën e përtejme dhe deklaron se çdo njeri do të paraqitet përpara Zotit për të dhënë llogari.

Kur recitohet kjo sure në namaz dhe pasi imami lexon ajetin e fundit që flet për llogaridhënien, duke ndjekur praktikën e Profetit Muhammed<sup>saws</sup>, besimtarët lutën me zë: O Allah! Na e bëj të lehtë llogaridhënien!



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. A të erdhi lajmi i (Orës) që do të pushtojë?

هَلْ أَتَاكَ حَدِيثُ الْعَاشِيَةِ ①

3. Atë ditë disa fytyra do të jenë të frikësuar,

وَجُوهٌ يَوْمَئِذٍ خَاشِعَةٌ ②

4. të lodhura e të rraskapitura (nga kërkimet e tyre të botës materiale).

عَامِلَةٌ نَّاصِبَةٌ ③

5. Do të hyjnë në një zjarr flakërues.

تَصَلُّى نَارًا حَامِيَةً ④

6. Atyre do t'u jepet për të pirë nga një burim i valuar.

تُسْقَى مِنْ عَيْنٍ أَنْيَّةٍ ⑤

7. Nuk do të kenë asnjë ushqim, përveç ferrash e gjembash të hidhura,

لَيْسَ لَهُمْ طَعَامٌ إِلَّا مِنْ صَرِيحٍ ⑥

8. që as nuk do t'i shëndoshin, e as nuk do t'ua shuajnë urinë.

لَا يُسْمِنُ وَلَا يُغْنِي مِنْ جُوعٍ ⑦

9. Atë ditë disa fytyra do të jenë të freskëta,

وَجُوهٌ يَوْمَئِذٍ نَّاعِمَةٌ ⑧

10. të kënaqura nga përpjekjet e tyre.

لِسَعِيهَا رَاضِيَةٌ ⑨

11. Në një xhenet të lartë.

فِي جَنَّةٍ عَالِيَةٍ ⑩

12. Nuk do të dëgjosh atje asnjë fjalë të kotë.

لَا تَسْمَعُ فِيهَا لِأَغْيَةٍ ⑪

13. Në të do të ketë një burim të rrjedhshëm.

فِيهَا عَيْنٌ جَارِيَةٌ ⑫

14. Në të do të ketë frone të lartë-  
suara,

فِيهَا سُرُرٌ مَّرْفُوعَةٌ ﴿١٤﴾

15. kupa të përzgjedhura,

وَ أَكْوَابٌ مَّوْضُوعَةٌ ﴿١٥﴾

16. jastëkë të renditur,

وَ نَمَارِقٌ مَّصْفُوفَةٌ ﴿١٦﴾

17. dhe qilima të shtruar.

وَ زَرَائِبٌ مَبْنُوتَةٌ ﴿١٧﴾

18. A nuk i shohin devetë se si janë  
krijuar?!

أَفَلَا يَنْظُرُونَ إِلَى الْإِبِلِ كَيْفَ خُلِقَتْ ﴿١٨﴾

19. Dhe qiellin se si është lartësuar?!

وَ إِلَى السَّمَاءِ كَيْفَ رُفِعَتْ ﴿١٩﴾

20. Po malin se si është ngulitur  
fort?!

وَ إِلَى الْجِبَالِ كَيْفَ نُصِبَتْ ﴿٢٠﴾

21. Dhe tokën se si është rrafshuar?!

وَ إِلَى الْأَرْضِ كَيْفَ سُطِحَتْ ﴿٢١﴾

22. Andaj, këshillo! Ti je vetëm  
këshillues.

فَذَكِّرْ ۚ إِنَّمَا أَنْتَ مُذَكِّرٌ ﴿٢٢﴾

23. Nuk je mbikëqyrës ndaj tyre.

لَسْتَ عَلَيْهِمْ بِمُضَيِّطٍ ﴿٢٣﴾

24. Kurse atë që e ktheu shpinën dhe  
mohoi,

إِلَّا مَنْ تَوَلَّى وَكُفِرَ ﴿٢٤﴾

25. Allahu do ta ndëshkojë me  
ndëshkimin më të madh.

فَيَعَذِّبُهُ اللَّهُ الْعَذَابَ الْأَكْبَرَ ﴿٢٥﴾

26. Sigurisht, te Ne është kthimi i  
tyre,

إِنَّ إِلَيْنَا إِيَابَهُمْ ﴿٢٦﴾

27. e më pas, po te Ne është llogaria  
e tyre.

ثُمَّ إِنَّ عَلَيْنَا حِسَابَهُمْ ﴿٢٧﴾

## Surja 89 – El-Fexhr

Surja El-Fexhr është zbritur në periudhën e hershme mekase dhe, bashkë me *bismillahin*, ka tridhjetë e një ajete.

Kuptimi i emrit të kësaj sureje është *agimi*. Dhe për agimin, kjo sure sjell dëshminë e dhjetë netëve, më pas dëshminë e dyshes dhe të një teku. Të gjitha bashkë bëhen trembëdhjetë. Këto trembëdhjetë vite parashikonin periudhën mekase trembëdhjetëvjeçare, pas së cilës, me hixhretin, do të lindte agimi.

Këto ajete komentohen edhe në kuptime të tjera. Njëri prej tyre është që agimi shënjon dritën që do të lindte në epokën e të mëvonshmëve, trembëdhjetë shekuj pas Profetit Muhammed<sup>savs</sup>. Megjithatë, kuptimi i parë është pikërisht agimi i kohës së Profetit<sup>savs</sup>.

Në ajetet e tjera të kësaj sureje, Zoti i Madhërishëm e nxit njeriun për t'i shërbyer njerëzimit. Tha: atij që mundohet për t'ua sjellë lirinë të varfërve dhe njerëzve të shtypur, i japim lajmin e mirë të një shpërblimi shumë të madh. Sihariqi më i madh për të është që në momentin e vdekjes, shpirti i tij do të dëgjojë thirrjen prej Zotit, i cili do t'i thotë:

*“O shpirt i qetësuar! Kthehu te Zoti yt, i kënaqur dhe duke gjetur kënaqësinë (e Tij)! Hyr te robërit e Mi dhe hyr në xhenetin Tim!”*



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit. بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①
2. Beto hem për agimin! وَالْفَجْرِ ①
3. Dhe për dhjetë netët! وَلَيَالٍ عَشْرٍ ①
4. Dhe për dyshen dhe për njëshin! وَالشَّفْعِ وَالْوَتْرِ ①
5. Dhe për natën kur kalon! وَأَثَلٍ إِذَا يُسِرُّ ①
6. Në këto, a ka betim për një që ka mend?!<sup>1</sup> هَلْ فِي ذَلِكَ قَسَمٌ لِذِي حَجْرِ ①
7. A nuk e ke parë se çfarë bëri Zoti yt me adët? أَلَمْ تَرَ كَيْفَ فَعَلَ رَبُّكَ بِعَادٍ ①
8. (Pra,) me (fisn e tyre) Irem që zotëronin shtyllat. إِرَمَ ذَاتِ الْعِمَادِ ①
9. Të tilla si ato nuk u ndërtuan në vende (të tjera). الَّتِي لَمْ يُخْلَقْ مِثْلَهَا فِي الْبِلَادِ ①
10. Dhe (çfarë bëri) me themudët, që çanë shkëmbinj nëpër luginë? وَتَمُودَ الَّذِينَ جَابُوا الصَّخْرَ بِالْوَادِ ①

1. Ajetet 2 – 6: Kurani i Shenjtë në këto ajete bën një deklaratë të fortë për të mençurit. Pasi Profeti Muhammed<sup>savs</sup> deklaroi profetërinë, periudha mekase vijoi për 13 vjet. Sidomos 10 vitet e fundit të kësaj periudhe ishin një terrnajë për shkak të persekutimeve të ashpra të mohuesve mekas. Kjo ishte një kohë kur mohuesit mekas u ushtronin dhunë sflitëse muslimanëve, derisa ata panë dritën e mërgimit.

Po këto ajete, disa komentues i shpjegojnë edhe në një rrafsh tjetër. Dyshja dhe njëshi janë tre shekujt e parë të Islamit, ku ishin sahabët, *tabeinët* dhe pasuesit e *tabeinëve*. Pas kësaj, muslimanët do të kalonin një epokë tejet të errët, të cilën Profeti<sup>savs</sup> e quajti “epokë *shtrembërishe*” e që do të zgjatej për dhjetë shekuj. Më pas, po sipas profesisë së Profetit<sup>savs</sup>, do të vinte Imam Mehdiu si një Profet nën shërbim të Kuranit dhe të Profetit Muhammed<sup>savs</sup>. Pra, pas trembëdhjetë shekujve, në shekullin e katërbëdhjetë erdhi Mesihu i Premtuar a.s.. Lexoni edhe 32:6.



11. Dhe me Faraonin e gozhdëve? وَفِرْعَوْنَ ذِي الْأَوْتَادِ ﴿١١﴾
12. Këta ishin rebeluar nëpër vende, الَّذِينَ طَعَوْا فِي الْبِلَادِ ﴿١٢﴾
13. dhe në to përhapën çrregullim të madh. فَاكْثُرُوا فِيهَا الْفَسَادَ ﴿١٣﴾
14. Atëherë, u ra kamxhiku i ndëshkimit të Zotit tënd. فَصَبَّ عَلَيْهِمْ رَبُّكَ سَوْطَ عَذَابٍ ﴿١٤﴾
15. Pa dyshim, Zoti yt rri në pritë. إِنَّ رَبَّكَ لَبِالْمِرْصَادِ ﴿١٥﴾
16. Njeriu është i tillë që kur Zoti i tij e vë në provë, duke e nderuar dhe duke e begatuar, ai thotë: “Zoti im më nderoi!” فَأَمَّا الْإِنْسَانُ إِذَا مَا ابْتَلَاهُ رَبُّهُ فَأَكْرَمَهُ  
وَنَعَّمَهُ فَيَقُولُ رَبِّي أَكْرَمَنِ ﴿١٦﴾
17. Dhe kur Ai e vë në provë duke ia ngushtuar mjetet e jetesës, ai thotë: “Zoti im më poshtëroi!” وَأَمَّا إِذَا مَا ابْتَلَاهُ فَقَدَرَ عَلَيْهِ رِزْقَهُ  
فَيَقُولُ رَبِّي أَهَانَنِ ﴿١٧﴾
18. Por jo! Ju nuk nderoni jetimët. كَلَّا بَلْ لَا تَكْرُمُونَ الْيَتِيمَ ﴿١٨﴾
19. As nuk nxitni njëri-tjetrin për të ushqyer të varfrit. وَلَا تَحْضُونَ عَلَىٰ طَعَامِ الْمُسْكِينِ ﴿١٩﴾
20. Trashëgiminë të gjithën e gllabëroni babëzisht. وَتَأْكُلُونَ التُّرَاثَ أَكْلًا لَّمًّا ﴿٢٠﴾
21. Pasurinë e doni marrëzisht. وَتُحِبُّونَ الْمَالَ حُبًّا جَمًّا ﴿٢١﴾
22. Dëgjoni! Kur toka të thërrmohet tërësisht! كَلَّا إِذَا دُكَّتِ الْأَرْضُ دَكًّا دَكًّا ﴿٢٢﴾
23. Do të vijë Zoti yt, gjithashtu engjëjt me rresht. وَجَاءَ رَبُّكَ وَالْمَلَكُ صَفًّا صَفًّا ﴿٢٣﴾
24. Atë ditë do ta sjellim xhehenemin. Atë ditë njeriu do të kërkojë këshillë, por ku ka më këshillë për të?! وَجَاءَ يَوْمَئِذٍ بِجَهَنَّمَ يَوْمَئِذٍ يَتَذَكَّرُ  
الْإِنْسَانُ وَأَنَّىٰ لَهُ الذِّكْرَىٰ ﴿٢٤﴾

25. Ai do të thotë: “Mjerë unë! Sikur të kisha çuar (diçka) përpara për jetën time!

يَقُولُ يَلَيْتَنِي قَدَّمْتُ لِحَيَاتِي ﴿٢٥﴾

26. Atë ditë askush nuk do ta ndëshkojë atë, siç ndëshkon Ai,

فَيَوْمَئِذٍ لَا يُعَذِّبُ عَذَابَهُ أَحَدٌ ﴿٢٦﴾

27. dhe askush nuk do ta shtrëngojë atë, siç shtrëngon Ai.

وَلَا يُؤْتِقُ وَثَاقَهُ أَحَدٌ ﴿٢٧﴾

28. O shpirt i qetësuar!

يَا أَيُّهَا النَّفْسُ الْمُطْمَئِنَّةُ ﴿٢٨﴾

29. Kthehu te Zoti yt, i kënaqur dhe duke gjetur kënaqësinë (e Tij)!

ارْجِعِي إِلَىٰ رَبِّكِ رَاضِيَةً مَّرْضِيَّةً ﴿٢٩﴾

30. Hyr te robërit e Mi,

فَادْخُلِي فِي عِبَادِي ﴿٣٠﴾

31. dhe hyr në xhenetin Tim!

وَادْخُلِي جَنَّتِي ﴿٣١﴾

## Surja 90 – El-Beled

Surja El-Beled është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka njëzet e një ajete.

Surja paraardhëse paraqiti si dëshmi në formë profecie netët e errëta të Mekës, të cilën e përmend edhe kjo sure që në fillim të saj. Duke iu drejtuar Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, Allahu i Madhërishëm i thotë: Paraqes këtë qytet si dëshmi gjersa të jesh ti, sepse më pas, ky nuk do të jetë qyteti i paqes!

Pastaj sjell si dëshmi brezat e ardhshëm për të pohuar se është caktuar për njeriun se ai do të mundohet vazhdimisht. Pasi Zoti ia dërgon dhuratën e Profetërisë, njeriu ballafaqohet me dy rrugë për zhvillimin e tij në besim dhe në botë. Njëra që është rrugë e mundimshme por që e çon në lartësitë e besimit dhe të botës, dhe tjetra që është e tatëpjetë dhe e lehtësisë, por që e çon drejt rënies. Njeriu në vend që ta zgjedhë të parën, e zgjedh të dytën, pra, të lehtë, dhe përfundon në humnerë. Këtu kjo sure edhe e sqaron se ngjitja në lartësi nuk do të thotë ngjitje fizike në ndonjë mal, por ngjitësit e vërtetë që arrijnë majën janë ata të cilët bëjnë përpjekje për të ushqyer të varfrit e uritur, për të çliruar skllevërit kur ata i pushton dikush, dhe për të ngritur në këmbë të dërrmuarit dhe të shkretët. Por ky synim është i tillë që nuk arrihet në një apo dy ditë. Kjo punë të kërkon të durosh dhe t'ua mësosh durimin edhe të tjerëve, të jesh i mëshirshëm dhe t'ua mësosh mëshirën edhe të tjerëve.

1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Beto hem për këtë qytet!

لَا أُقْسِمُ بِهَذَا الْبَلَدِ ①

3. Ndërkohë, ti (një ditë) do të zbresësh në këtë qytet.

وَأَنْتَ حِلٌّ بِهَذَا الْبَلَدِ ②

4. Dhe (beto hem) për babain dhe të lindurin e tij!

وَوَالِدٍ وَمَا وَلَدٍ ③

5. Sigurisht, Ne e krijuam njeriun që të jetë në përpjekje të vazhdueshme.

لَقَدْ خَلَقْنَا الْإِنْسَانَ فِي كَبَدٍ ④

6. A mendon ai se askush nuk do ta mposhtë atë?!

أَيَحْسَبُ أَنْ لَنْ يَقْدِرَ عَلَيْهِ أَحَدٌ ⑤

7. Ai thotë: “Kam shpenzuar pasuri të madhe!”

يَقُولُ أَهْلَكْتُ مَا لَا لُبَدًا ⑥

8. A mendon ai se nuk e ka parë dikush?!

أَيَحْسَبُ أَنْ لَمْ يَرَهُ أَحَدٌ ⑦

9. A nuk i dhamë Ne dy sy?!

أَلَمْ نَجْعَلْ لَهُ عَيْنَيْنِ ⑧

10. Një gjuhë dhe dy buzë?!

وَلِسَانًا وَشَفَتَيْنِ ⑨

11. Dhe i treguam dy rrugë.

وَهَدَيْنَاهُ النَّجْدَيْنِ ⑩

12. Por ai nuk iu ngjit të përpjetës.

فَلَا اقْتَحَمَ الْعَقَبَةَ ⑪

13. E si mund ta dish ti se ç'është e përpjeta?

وَمَا أَدْرَاكَ مَا الْعَقَبَةُ ⑫

14. (Ajo është) të lirosh një skllav,

فَكَ رَقَبَةً ⑬

15. ose të ushqesh në një ditë urie  
 أَوْ اِطْعَمْ فِي يَوْمٍ ذِي مَسْغَبَةٍ ﴿١٥﴾
16. një jetim nga të afërmit,  
 يَتِيمًا ذَا مَقْرَبَةٍ ﴿١٦﴾
17. ose një të varfër përtokë.  
 أَوْ مِسْكِينًا ذَا مَتْرَبَةٍ ﴿١٧﴾
18. Dhe të bëhesh ndër ata që besuan, (që) porosisin njëri-tjetrin për durim dhe porosisin njëri-tjetrin për mëshirë.  
 ثُمَّ كَانَ مِنَ الَّذِينَ آمَنُوا وَتَوَاصَوْا بِالصَّبْرِ  
 وَتَوَاصَوْا بِالْمَرْحَمَةِ ﴿١٨﴾
19. Pikërisht këta janë njerëzit e së djathtës.  
 أُولَٰئِكَ أَصْحَابُ الْمَيْمَنَةِ ﴿١٩﴾
20. Kurse ata që mohuan shenjat Tona, janë njerëzit e së majtës.  
 وَالَّذِينَ كَفَرُوا بِآيَاتِنَا هُمْ أَصْحَابُ الْمَشْأَمَةِ ﴿٢٠﴾
21. Atyre do t'u bjerë një zjarr i mbyllur.  
 عَلَيْهِمْ نَارٌ مُّوَصَّدَةٌ ﴿٢١﴾

## Surja 91 – Esh-Shems

Surja Esh-Shems është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka gjashtëmbëdhjetë ajete.

Edhe një herë tjetër vjen profecia se dielli i Islamit do të lindë, dhe duke përfituar nga drita e këtij dielli, edhe hëna do të ndriçohet sërish. Më pas, do të lindë një agim, të cilin do ta pasojë një natë e errët, sepse njerëzit gëzojnë agimin, por pas çdo dite të zbardhur, kaplohen nga errësitat e harresave e të devijimeve.

Më pas kjo sure bën deklaratë të madhe që Allahu i Madhërishëm krijoi çdo njeri me drejtësi, duke ia shpallur që në gjenezën e tij të mirën dhe të keqen. Më pas, kushdo që do t'i shfrytëzojë këto dhunti që i ka dhënë Zoti, do të ketë sukses, dhe kushdo që do t'i shkelë ato, do të shkatërrohet.

Pas kësaj, Zoti i Madhërishëm jep shembullin e popullit të Themudit dhe të devesë së Profetit të tyre. Ne e dimë që *Hazret Salihu*<sup>as</sup> ishte Profeti i tyre dhe ai kishte një deve, të cilën e përdorte për të udhëtuar e për t'ua kumtuar njerëzve mesazhin e Zotit. Kur ata ia prenë këmbët devesë dhe e therën, Zoti u dërgoi një ndëshkim të madh. Ndoshta ky shembull vjen për të treguar se sa herë që armiqtë e Profetëve do të tentojnë t'ua heqin mjetet e kumtimit të mesazhit, do të shkatërrohen.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Beto hem për diellin dhe për shkëlqimin e tij!

وَالشَّمْسِ وَضُحَاهَا ①

3. Dhe për hënën kur ajo e ndjek atë!

وَاقْتَرِ إِذَا تَلَّهَا ①

4. Dhe për ditën kur e ndriçon atë!

وَالنَّهَارِ إِذَا جَلَّهَا ①

5. Dhe për natën kur e mbulon atë!

وَاللَّيْلِ إِذَا يَغْشَاهَا ①

6. Dhe për qiellin dhe atë që e ndërtoi!

وَالسَّمَاءِ وَمَا بَنَاهَا ①

7. Dhe për tokën dhe atë që e shtroi.

وَالْأَرْضِ وَمَا طَحَاهَا ①

8. Dhe për çdo shpirt dhe atë që e përsosi!

وَنَفْسٍ وَمَا سَوَّاهَا ①

9. Ai (në gjenezën e tij) shpalli çfarë është e shtrembëta dhe e drejta për të.

فَالْهَمَّهَا فَجُورَهَا وَتَقْوَاهَا ①

10. Pa dyshim, fitoi ai që e pastroi atë,

قَدْ أَفْلَحَ مَنْ زَكَّاهَا ①

11. dhe humbi ai që e shkeli atë.

وَقَدْ خَابَ مَنْ دَسَّاهَا ①

12. Themudët mohuan për shkak të tërbimit të tyre,

كَذَّبَتْ ثَمُودُ بِطَغْوَاهَا ①

13. (pra, kujtoni) kur u ngrit më i ligu i tyre.

إِذِ انبَعَثَ أَشْقَاهَا ①

14. Atëherë i Dërguari i Allahut u tha: “(Kujdes) devenë e Allahut dhe pirjen e saj te burimi!”

فَقَالَ لَهُمْ رَسُولُ اللَّهِ نَاقَةَ اللَّهِ وَسُقْيَاهَا ۖ

15. Ata e quajtën gënjeshtar dhe e therën (devenë). Atëherë Zoti i tyre i goditi në mënyrë të njëpasnjëshme për shkak të mëkatit të tyre, derisa e rrafshoi (vendin).

فَكَذَّبُوهُ فَعَقَرُوهَا ۖ فَدَمْدَمَ عَلَيْهِمْ رَبُّهُمْ بِذُنُوبِهِمْ فَسَوَّاهَا ۖ

16. Dhe nuk u interesua fare për fundin e tij.<sup>1</sup>

وَلَا يَخَافُ عُقْبَاهَا ۖ

1. Në parathënie, kjo sure është shpjeguar shkurtimisht në raport me suret e mëparshme, por në një këndvështrim tjetër, po kjo sure shpalos një temë të thellë shpirtërore. Përsosmëritë që gjenden të shpërndara në gjërat që përmend kjo sure nga ajeti nr. 2 e deri në ajetin nr. 7, shpirti i njeriut të përsosur i përmbledh të gjitha në veten e tij dhe ashtu siç këto gjëra i shërbejnë njerëzimit në mënyra të ndryshme, njeriu i përsosur i shërben i vetëm në të gjitha mënyrat. Pastaj thotë: U lirua nga vdekja dhe gjeti shpëtimin ai që e pastroi shpirtin e vet në këtë mënyrë, pra që u bë tërësisht i Zotit sikur dielli, hëna, toka etj., dhe u shërbeu krijesave të Zotit.

Të mos harrojmë që në këtë kontekst jeta nënkupton përjetësinë, që do të gjejë njeriu i përsosur. Kjo do të thotë se zbatimi praktik i Librit të Zotit sjell përjetësinë në jetën tjetër, e cila do të qëndrojë përgjithmonë falë ushqimit që vjen prej takimit me Zotin. Pastaj thotë: u shkatërrua dhe u dëshpërua nga jeta ai që e shkeli në baltë shpirtin e vet, dhe nuk përdori forcat që i ishin dhënë për të arritur përsosmëritë e caktuara, rrjedhimisht nuk i arriti përsosmëritë, përkundrazi u kthye duke kaluar një jetë të ligë.

Më pas si shembull tha se ngjarja e popullit të Themudit është e ngjashme me ngjarjen e këtij fatligu. Ata e lënduan devenë që ishte deveja e Allahut dhe e ndaluan të pinte ujë nga burimi. Kështu që, fatligu në të vërtetë e lëndoi devenë e Allahut dhe e privoi nga burimi. Kjo tregon që shpirti i njeriut është deveja e Allahut, mbi të cilën njeriu udhëton. Pra, zemra e njeriut është vendi ku projektohen manifestimet Hyjnore. Kurse uji i devesë nënkupton dashurinë dhe njohjen e Zotit, me të cilën ajo rron.

Më pas tha që populli i Themudit kur e lëndoi devenë dhe e ndaloi të pinte ujin e saj, ata i zuri ndëshkimi. Atëherë Zoti i Madhërishëm nuk e mori fare në konsideratë se çfarë do të ndodhte me fëmijët dhe vejushat e tyre, pas ndëshkimit të tyre. Në të njëjtën mënyrë, edhe ai që lëndon devenë e tij dhe e ndalon nga uji, pra e lëndon shpirtin e vet dhe nuk dëshiron ta çojë deri në përsosmëri, do të shkatërrohet.

Duhet sqaruar se betimet e Zotit në këto ajete, nuk janë në të njëjtin rrafsh me betimet e njerëzve. Në fakt, Zoti bën dy lloje veprash: të parat janë të hapura dhe që i kuptojnë të gjithë dhe askush nuk ka kundërshtime për natyrën e tyre, dhe të dytat janë të tilla që kanë nevojë për arsytim që duhet zbërthyer (deduktiv), ku njerëzit tokësorë gabojnë në domethënien e tyre dhe i kundërshtojnë. Prandaj, Zoti i Madhërishëm deshi të provojë çështjet deduktive, duke sjellë dëshminë e veprave të Tij të dukshme. Tani, të gjithë e dinë që dielli, hëna, dita, nata,



qielli dhe toka i kanë ato cilësi që përmend kjo sure, por që po këto cilësi i ka edhe njeriu, nuk e di gjithkush. Prandaj, edhe këtu, Zoti i Madhërishëm solli si dëshmi veprat e Tij të dukshme për të zbuluar veprat e Tij të padukshme. Si të thuash, Ai thotë: Nëse jeni në mëdyshje në i mbart njeriu këto cilësi, atëherë përsiatni diellin, hënën etj., që i kanë këto cilësi në mënyrë të dukshme, dhe ju e dini që njeriu është një mikrokozmos, në të cilin është gdhendur skema e të gjithë kozmosit. Pra, kur trupat e mëdhenj qiellorë i kanë këto veti që u bëjnë dobi krijesave, si mundet që njeriu që është krijuar si më i madhi dhe më i larti prej tyre në shkallë, të mund të mbetet i privuar nga këto cilësi?! Përkundrazi, edhe ai është porsi dielli, sepse ka dritën e dijes dhe mendjes, me të cilën ai mund ta ndriçojë gjithë botën; ai është porsi hëna, sepse merr dritën e vizionit (*keshf*), dhe të shpalljes (*ilham dhe vahji*) prej Zotit të Lartësuar dhe ua përcjell të tjerëve që ende nuk e kanë arritur përsosmërinë njerëzore. Atëherë, si mund të thoni që të qenët *profet* është gënjeshtër dhe të gjithë të Dërguarit, Sheriatet dhe Librat qiellorë janë mashtrime dhe përfitime të njeriut?! Ju vëreni se kur zbardhet dita, zbardhen të gjitha rrugët dhe spikaten të gjitha ulje-ngritjet. Njësoj si kjo, njeriu i përsosur është dita e zbardhjes shpirtërore, me agimin e së cilës, çdo rrugë vihet në dukje, dhe ai tregon rrugën e vërtetë se ku dhe si shkon, sepse ai është dita e zbardhur e drejtësisë dhe e vërtetësisë. Ju gjithashtu vëreni se si nata merr në strehë të dërrmuarit dhe të rraskapiturit. Punëtorët të këputur prej lodhjes së ditës, pushojnë në prehrin e natës. Pra, nata lodhjen e tyre ua shndërron në qetësi dhe përveç kësaj, ajo shërben edhe si mbulesë për çdokënd. Njësoj si kjo, edhe robërit e përsosur të Zotit që gëzojnë shpallje prej Zotit, vijnë për t'u dhënë prehje njerëzve të botës dhe, atyre që janë mendarë, u sjellin lehtësi në punët e tyre rraskapitëse. Falë tyre, zgjidhen çështje të mëdha të njohurive rreth Zotit. Po kështu, shpallja e Zotit shërben si mbulesë për dobësitë e mendjes së njeriut, saqë nuk lejon t'i dalin në shesh gabimet dhe papastërtitë e saj, sikur nata që shërben në të njëjtën mënyrë për krijesat. Sepse duke përfituar nga drita e shpalljes, i mençuri bën vetëreformim dhe në saje të bekimit të shpalljes Hyjnore, e shpëton veten nga ekspozimi.

Po ashtu, robërit e përsosur të Zotit, sidomos Profetët e Tij dhe ata që gëzojnë shpallje prej Tij, i marrin në strehë të gjithë ata që janë të pastrehë dhe porsi qielli lëshojnë shiun e bekimeve të tyre. Por njëherësh ata kanë edhe cilësinë e tokës, sepse nga shpirtrat e tyre të pastra, lartësohen pemët e diturive të shumëllojshme dhe njerëzit përfitojnë nga hija, frutat dhe lulet e tyre. Pra, ligji i natyrës që është i dukshëm për të gjithë, përbën një dëshmi të ligjit të fshehtë që sapo përshkruam. Shkurt, Zoti i Madhërishëm solli dëshminë e të dukshmit, në formë betimesh, për ta vërtetuar të padukshmen. Më shumë për këtë temë, lexoni librin “Filozofia e mësimëve të Islamit”, nga *Hazret Mirza Ghulam Ahmed*<sup>as</sup>, botuar në Tiranë, 2019.

## Surja 92 – El-Lejl

Surja El-Lejl është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka njëzet e dy ajete.

Pas sures Esh-Shems (Dielli) vjen surja El-Lejl (Nata), njësoj siç nata vjen pas ditës, por këtu nuk flitet thjesht për natë fizike, madje e gjithë surja tregon aspekte të ndryshme të natës shpirtërore. Gjithashtu, na jep edhe lajmin e mirë që pas natës do të lindë sërish dita. Ashtu siç dita dhe nata kanë ndikime të ndryshme, edhe përpjekjet e njeriut kur janë të errëta, i ngjajnë natës, dhe kur janë të ndritshme, i ngjajnë ditës. Çdo njeri do të shpërblehet në bazë të veprave dhe synimeve të tij. Kështu që, ata që kanë drujtje ndaj Allahut, që shpenzojnë për mirëqenien e të varfërve dhe që pranojnë fjalën e mirë kur ajo u vjen, të tillëve Allahu i Madhërishëm do t'ua lehtësojë rrugëtimin. Karshi tyre, ata që tregohen koprracë e të pavëmendshëm ndaj pasojave të veprave të tyre, dhe kur u vjen fjala e mirë dhe e pastër, e mohojnë duke e quajtur gënjeshtër. Për ta Allahu i Madhërishëm thotë – Ne do t'ua vështirësojmë rrugëtimin.

Më pas, keqbërësi që u përmend më sipër, Zoti e frikëson nga një zjarr flakërues, ose, nëse nuk tërhiqet, ai do të hidhet në të. Kurse punëmiri që shpenzoi pasurinë e tij në vepra të mira dhe që pati drujtje ndaj Zotit, Zoti do ta shpëtojë atë.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.
 

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①
2. Beto hem për natën kur mbulon!
 

وَاللَّيْلِ إِذَا يَغْشَىٰ ①
3. Dhe për ditën kur zbardhet!
 

وَالنَّهَارِ إِذَا تَجَلَّىٰ ①
4. Dhe për atë që Ai krijoi (në) mashkull dhe femër!
 

وَمَا خَلَقَ الذَّكَرَ وَالْأُنثَىٰ ①
5. Përpjekjet tuaja pa dyshim janë të ndara.
 

إِنَّ سَعْيَكُمْ لَشَتَّىٰ ①
6. Andaj, ai që dhuroi (në rrugën e së vërtetës) dhe pati druajtje (ndaj Zotit),
 

فَأَمَّا مَنْ أَعْطَىٰ وَاتَّقَىٰ ①
7. dhe vërtetoi më të mirën (duke e pranuar atë),
 

وَصَدَّقَ بِالْحُسْنَىٰ ①
8. Ne patjetër do t'ia mundësojmë lehtësinë.
 

فَسَنِّيئِرُهُ لِيَّسْرَىٰ ①
9. Kurse ai që u tregua koprrac dhe shpërfillës,
 

وَأَمَّا مَنْ بَخِلَ وَاسْتَغْنَىٰ ①
10. dhe e quajti gënjeshtër më të mirën,
 

وَكَذَّبَ بِالْحُسْنَىٰ ①
11. Ne patjetër do ta shtrëngojmë.
 

فَسَنِّيئِرُهُ لِيَّعْسْرَىٰ ①
12. Kur ai të shkatërrohet, pasuria e tij nuk do t'i vijë në ndihmë aspak.
 

وَمَا يُغْنِي عَنْهُ مَالُهُ إِذَا تَرَدَّىٰ ①
13. Sigurisht, Ne kemi përsipër të udhëzuarit,
 

إِنَّ عَلَيْنَا لَلْهُدَىٰ ①

14. dhe sigurisht, (edhe) fundi, edhe fillimi janë nën kontrollin Tonë.

وَإِنَّا لِلْآخِرَةِ وَالْأُولَىٰ ﴿١٤﴾

15. Andaj, Unë ju frikësoj nga një zjarr flakërues.

فَأَنْذَرْتُكُمْ نَارًا تَلَظَّىٰ ﴿١٥﴾

16. Askush nuk do të hyjë në të, përveç fatligut të madh,

لَا يَصِلُهَا إِلَّا الْاَشْقَىٰ ﴿١٦﴾

17. i cili mohoi dhe e ktheu shpinën.

الَّذِي كَذَّبَ وَتَوَلَّىٰ ﴿١٧﴾

18. Dhe do të shpëtojë prej tij ai që është shumë i druajtur,

وَسَيَجْزِيهَا الْاِتَّقَىٰ ﴿١٨﴾

19. që jep pasurinë e tij për t'u vetëpastruar;

الَّذِي يُؤْتِي مَالَهُ يَتَزَكَّىٰ ﴿١٩﴾

20. dhe që nuk i detyrohet asnjërit për ndonjë nder që ta shlyejë;

وَمَا لِأَحَدٍ عِنْدَهُ مِنْ نِعْمَةٍ تُجْزَىٰ ﴿٢٠﴾

21. por e bën vetëm duke kërkuar kënaqësinë e Zotit të tij të Lartësuar.

إِلَّا ابْتِغَاءَ وَجْهِ رَبِّهِ الْأَعْلَىٰ ﴿٢١﴾

22. Dhe Ai patjetër do të kënaqet.

يَعْلَمُ وَسَوْفَ يُرْضَىٰ ﴿٢٢﴾

## Surja 93 – Ed-Duha

Surja Ed-Duha është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka dymbëdhjetë ajete.

Edhe kjo sure jep lajmin e mirë të një dite që do të jetë shumë e ndriçuar, dhe gjithashtu parashikon edhe një natë që do të vijë më pas. Duke iu drejtuar Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, kjo sure i thotë:

Allahu i Madhërishëm nuk do të të lërë ty as edhe në kohët më të errëta dhe të vështira; e ardhmja jote do të jetë më e mirë se e kaluara dhe se Allahu do të të japë shumëçka. Prandaj, kujdesu për jetimët; mos përzë lypësin dhe mos i fshih bekimet e Zotit, por tregoja ato njerëzve. Sa më shumë që ti të shpenzosh në rrugën e Allahut, aq më shumë Allahu do të ta shtojë.



- |                                                                                        |                                                    |
|----------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|
| <p>1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.</p>                    | <p>بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①</p>     |
| <p>2. Beto hem për dritën e paradites!</p>                                             | <p>وَالضُّحَى ①</p>                                |
| <p>3. Dhe për natën kur errësohet!</p>                                                 | <p>وَاللَّيْلِ إِذَا سَجَى ②</p>                   |
| <p>4. Zoti yt as nuk të braktisi, as nuk të urreu.</p>                                 | <p>مَا وَدَّعَكَ رَبُّكَ وَمَا قَلَى ③</p>         |
| <p>5. Pa dyshim, e ardhshmja është më e mirë për ty sesa e mëparshmja.<sup>1</sup></p> | <p>وَاللَّخِرَةُ خَيْرٌ لَّكَ مِنَ الْأُولَى ④</p> |
| <p>6. Zoti yt do të të japë, dhe ti do të kënaqesh.</p>                                | <p>وَلَسَوْفَ يُعْطِيكَ رَبُّكَ فَتَرْضَى ⑤</p>    |
| <p>7. A nuk të gjeti Ai jetim, e të strehoi;</p>                                       | <p>أَلَمْ يَجِدْكَ يَتِيمًا فَآوَى ⑥</p>           |
| <p>8. dhe të gjeti të përhumbur, e të udhëzoi;</p>                                     | <p>وَوَجَدَكَ ضَالًّا فَهَدَى ⑦</p>                |
| <p>9. dhe të gjeti me familje të madhe, e të pasuroi?!<sup>2</sup></p>                 | <p>وَوَجَدَكَ عَائِلًا فَأَغْنَى ⑧</p>             |
| <p>10. Andaj, jetimin mos e shtyp!</p>                                                 | <p>فَأَمَّا الْيَتِيمَ فَلَا تَقْهَرْ ⑨</p>        |

1. E ardhshmja (*ahireti*) dhe e mëparshmja (*ula*) që janë përmendur në këtë ajet, nënkuptojnë që çdo çast i jetës së Profetit Muhammed<sup>savs</sup> ishte më i mirë sesa çasti i kaluar, sepse ai gjithnjë ishte në rrugëtimin e tij drejt Zotit, pa asnjë devijim.

2. Fjala *dal-len* në ajetin nr. 8, nuk nënkupton “i devijuar”, por do të thotë se Profeti Muhammed<sup>savs</sup> ishte i përhumbur në dashurinë e Allahut aq shumë sa që e kishte harruar tërësisht edhe vetveten. Kurse fjala *'ailen* aludon për *umetin* e madh që do t'i jepej Profetit<sup>savs</sup>. Asnjë Profet nuk pati *umet* kaq të madh, sa i është dhuruar Profetit Muhammed<sup>savs</sup>.

11. Lypësin mos e përzë!

وَأَمَّا السَّائِلَ فَلَا تَنْهَرْ ۝١١

12. Dhe bekimin e Zotit tënd,  
përmende!<sup>3</sup>

وَأَمَّا بِنِعْمَةِ رَبِّكَ فَحَدِّثْ ۝١٢

---

3. Ka plot hadithe që tregojnë se bekimet dhe mirësitë tokësore që Allahu i Madhërishëm ia jepte Profetit<sup>savs</sup>, Profeti<sup>savs</sup> nuk i fshihte nga njerëzit, përkundrazi, i shpërndante bujarisht në mesin e tyre. Kurse pozitat shpirtërore që Allahu i dhuroi atij, po të mos shoqëroheshin me urdhrin e Allahut për t'ua zbuluar ato, ai do t'i mbante vetëm te vetja e tij. Përmendja e bekimeve tokësore ishte e nevojshme, në mënyrë që nevojtarët të viheshin në dijeni dhe të shkonin tek ai. Mirësjellja e Profetit me ta nuk ishte ndonjë gjest i huaj, por ishte si ai kujdes që bën prindi ndaj fëmijëve të tij, dhe që në këmbim, nuk kërkon asnjë falënderim.

## Surja 94 – El-Inshirah

Surja El-Inshirah është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka nëntë ajete.

Pasi përmend morale të larta të Profetit<sup>savs</sup>, Zoti i Madhërishëm në këtë sure pohon:

A nuk të kemi hapur ty kraharorin?! Barrën e amanetit që ti e kishe mbajtur, a nuk ta kemi hequr?! Pra, a nuk të mundësuam ta përmbushje detyrën tënde?! Dhe a nuk të ta lartësuam emrin ty?! Kështu që, mos harro të vërtetën e përhershme që pas çdo vështirësie, vjen lehtësia; pas çdo vështirësie, vjen lehtësia. Kjo vlen edhe për çështjet e kësaj bote, edhe për çështjet shpirtërore. Andaj, kur ti të lirohesh nga angazhimet e tërë ditës, çohu përpara Zotit tënd gjatë natës dhe qetësoje zemrën me dashurinë e Tij.





1. Me emrin e Allahut, të Gjithë-mëshirshmit, Mëshirëbërësit.
2. A nuk ta hapëm ty kraharorin?!
3. Dhe ta hoqëm barrën?!
4. E cila ta thyente kurrizin.
5. Dhe ta lartësuam emrin.
6. Dhe pa dyshim, me vështirësinë, vjen (edhe) lehtësia.
7. Pa dyshim, me vështirësinë, vjen (edhe) lehtësia.
8. Pra, kur të lirohesh, përpiqu;
9. dhe te Zoti yt me përkushtim angazhohu.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

أَلَمْ نَشْرَحْ لَكَ صَدْرَكَ ②

وَوَضَعْنَا عَنكَ وِزْرَكَ ③

الَّذِي أَنْقَضَ ظَهْرَكَ ④

وَرَفَعْنَا لَكَ ذِكْرَكَ ⑤

فَإِنَّ مَعَ الْعُسْرِ يُسْرًا ⑥

إِنَّ مَعَ الْعُسْرِ يُسْرًا ⑦

فَإِذَا فَرَغْتَ فَانصَبْ ⑧

وَإِلَىٰ رَبِّكَ فَارْغَبْ ⑨

## Surja 95 – Et-Tin

Surja Et-Tin është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka nëntë ajete.

Surja Et-Tin ndër të tjera sjell edhe shpjegimin e dy ajeteve të sures paraardhëse El-Inshirah: “*me vështirësinë, vjen (edhe) lehtësia. Pa dyshim, me vështirësinë, vjen (edhe) lehtësia.*”

Kjo sure përmend një evolucion të përkryer. Sjell dëshminë e fikut, dhe të ullirit, që simbolizojnë Ademin [Bibla, Zanafilla 3:7] dhe Nuhun [Zanafilla 8:11], paqja qoftë mbi ta, dhe më pas, sjell dëshminë e Malit të Sinait, që i referohet Hazret Musait<sup>as</sup>, konkretisht malit mbi të cilin Allahu ia kishte treguar manifestimin e Tij. Më pas, sjell dëshminë e qytetit të paqes, që ishte vatra e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>. Duke renditur këtë zhvillim shpirtëror e shkallëzor, Zoti i Madhërishëm deklaroi: Ja kështu e kemi zhvilluar njeriun, nga një gjendje e ulët te gjendja e tij më e lartë; por fatligu që nuk përfiton nga ky zhvillim, atë e kthejmë në gjendjen më të ulët. Pra, njerëzit e tillë fillojnë rrugëtimin e tyre drejt rënies shpirtërore për të shkuar në regresin social. Por ata që besuan dhe bënë të mira, do të gëzojnë lartësime të pafundme shpirtërore. Andaj, për atë që do ta kundërshtojë dhe do ta mohojë të Dërguarin e Allahut<sup>savs</sup> edhe pas kësaj, Allahu do të bëjë gjykimin më të drejtë.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithë-  
mëshirshmit, Mëshirëbërësit. بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①
2. Beto hem për fikun dhe për ullirin! وَالتِّينِ وَالزَّيْتُونِ ①
3. Dhe për Malin e Sinait! وَطُورِ سَيْنِينَ ①
4. Dhe për këtë qytet të paqes! وَهَذَا الْبَلَدِ الْأَمِينِ ①
5. Sigurisht, Ne e krijuam njeriun në  
gjendjen më të mirë të zhvillimit.<sup>1</sup> لَقَدْ خَلَقْنَا الْإِنْسَانَ فِي أَحْسَنِ تَقْوِيمٍ ①
6. Më pas, e kthjem në gjendjen më  
të ulët.<sup>2</sup> ثُمَّ رَدَدْنَاهُ أَسْفَلَ سَافِلِينَ ①
7. Përveç atyre që besuan dhe bënë  
të mira; ata do të kenë shpërblim  
pambarim. إِلَّا الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ فَلَهُمْ  
أَجْرٌ غَيْرٌ مِّمَّنُونِ ①
8. Atëherë ç'të shtyn ty që të mohosh  
Ditën e Gjykimit? فَمَا يَكْذِبُكَ بَعْدَ الْبَدِينِ ①
9. A nuk është Allahu Gjykatësi më  
i mirë?! يَعْلَمُ الْغَيْبَاتِ اللَّهُ بِأَحْكَمِ الْحَاكِمِينَ ①

1. Për këtë kuptim të fjalës “*takvim*”, shikoni fjalorin *Mufredat*, të Imam Ragibit<sup>ra</sup>.

2. Ajetet 5 – 6: Këto ajete flasin për zhvillimin e vazhdueshëm të njeriut sesi Allahu e sjell atë nga gjendja më e ulët, tek gjendjet më të larta shpirtërore. Kuptimi leksikor i fjalës *takvim* është të rregullosh diçka duke e përmirësuar atë. Më pas Zoti tha: Ne e kthjem në gjendjen më të ulët, pra aty ku ai e kishte filluar zhvillimin. Dhe këta që kthehen në gjendjen më të ulët janë keqbërësit dhe mosmirënjohësit ndaj Zotit. Të tillët edhe pse quhen njerëz, bëhen krijesat më të këqija. Por besimtarët e vërtetë që bëjnë edhe vepra të mira, kanë lajmin e mirë të zhvillimit të pandalshëm sipas aftësive të tyre. Se si njeriu duke qenë krijesat më e mirë mund të kthehet në krijesën më të keqe, na e shpjegon vetë Profeti Muhammed<sup>savs</sup>. Ai bën profecinë فِي السَّمَاءِ أَدِيمِ تَحْتَ مَنْ تَحْتِ أَدِيمِ السَّمَاءِ ① që në epokën e të mëvonshmeve vetë *dijetarët* e të ashtuquajturve muslimanë *do të jenë krijesat më sherrxhinj nën kupën e qiellit*. (Mishkatul-Mesabih, Kitabul-’ilm, nr. i hadithit 276). Lexoni edhe parathënien e sures.

## Surja 96 – El-Alek

Surja El-Alek është surja e parë që u zbrit dhe është mekase. Bashkë me *bismil-lahin*, ajo ka njëzet ajete.

Zbritja e shpalljes Kuranore filloi me këtë sure, në të cilën Allahu i Madhërishëm porositi Profetin Muhammed<sup>savs</sup> të lexojë me emrin e Zotit të tij që krijoi gjithçka. Më pas, sërish e porositi: Lexo me emrin e Zotit tënd që është më i Nderuari, i cili te pena ka lënë sekretin e të gjitha përparimeve njerëzore [fjala arabe “*ekrem*” do të thotë *më i nderuari, më bujari*]. Vërtet, nëse njeriut nuk do t’i jepej dhuntia e të shkruarit, ai nuk do të gëzonte asnjë përparim.

Më pas, Zoti i Madhërishëm paralajmëron çdokënd që krijon pengesa në adhurimin e Zotit. Duke iu drejtuar njeriut të tillë, Zoti i thotë: Nëse nuk tërhiqesh, Ne do t’i kapim balluket e tua të gënjeshtërtë, më pas, ti thirr kë të duash për ndihmë, Ne kemi engjëj të xehenemit që do të jenë shumë të rreptë ndaj tyre.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Lexo me emrin e Zotit tënd që krijoi.

اقْرَأْ بِاسْمِ رَبِّكَ الَّذِي خَلَقَ ②

3. E krijoi njeriun me një ngjizje gjaku.

خَلَقَ الْإِنْسَانَ مِنْ عَلَقٍ ③

4. Lexo! Zoti yt është më Bujari.

اقْرَأْ وَرَبُّكَ الْأَكْرَمُ ④

5. Ai që (i) mësoi (atij) me anë të penës.

الَّذِي عَلَّمَ بِالْقَلَمِ ⑤

6. I mësoi njeriut atë që ai nuk e dinte.

عَلَّمَ الْإِنْسَانَ مَا لَمْ يَعْلَمْ ⑥

7. Dëgjoni! Njeriu patjetër rebelohet.

كَلَّا إِنَّ الْإِنْسَانَ لِكَيْفَى ⑦

8. Sepse e kujton veten të pavarur.

أَنْ رَأَهُ اسْتَعْيَى ⑧

9. Sigurisht, te Zoti yt është kthimi.

إِنَّ إِلَىٰ رَبِّكَ الرُّجْعَى ⑨

10. A nuk e pe atë që ndalon

أَرَأَيْتَ الَّذِي يَنْهَى ⑩

11. robin të falë namazin?!<sup>1</sup>

عَبْدًا إِذَا صَلَّى ⑪

12. Çka mendon ti nëse ai (rob) është në udhë të drejtë?!

أَرَأَيْتَ إِنْ كَانَ عَلَىٰ الْهُدَىٰ ⑫

13. Ose nëse porosit për druajtjen (ndaj Zotit)?!

أَوْ أَمَرَ بِالتَّقْوَىٰ ⑬

1. Ajetet 10-11 përshkruajnë një pamje të dhimbshme të periudhës së parë të Islamit, kur disa fatligë e pengonin të Dërguarin e Allahut<sup>savs</sup> nga falja e namazit, duke i ushtruar lloj-lloj mizorish.

14. E çka mendon ti nëse ai (ndaluesi i faljes së namazit) mohon dhe e kthen shpinën?!

أَرَأَيْتَ إِنْ كَذَّبَ وَتَوَلَّى ۖ

15. A nuk e di ai që Allahu me të vërtetë sheh!

أَلَمْ يَعْلَم بِأَنَّ اللَّهَ يَرَى ۖ

16. Dëgjoni! Nëse ai nuk tërhiqet, do ta tërheqim Ne zvarrë për ballukesh,

كَلَّا لَئِنْ لَمْ يَنْتَهِ لَنَسْفَعًا بِالنَّاصِيَةِ ۖ

17. të ballit gënjeshtar (e) mëkatar!

نَاصِيَةٍ كَاذِبَةٍ خَاطِئَةٍ ۖ

18. Ai le të thërrasë shoqërinë e tij.

فَلْيَدْعُ نَادِيَهُ ۖ

19. Ne do të thërrasim engjëjt e xhehenemit.

سَنَدْعُ الزَّبَانِيَةَ ۖ

20. Dëgjo! Ti mos e ndiq atë, bjer në sexhde dhe afrohu!

كَلَّا ۖ لَا تَطْعُهُمْ وَأَسْجُدْ وَاقْتَرِبْ ۖ

Sexhdeja XV

## Surja 97 – El-Kadr

Surja El-Kadr është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka gjashtë ajete.

Kjo sure sjell lajmin e mirë që Shpallja Kuranore që ka filluar të zbresë, ka fuqinë të largojë çdolloj errësire. Kështu që, ndër të tjera, këtu përmendet edhe nata tejet e errët e epokës së Profetit<sup>savs</sup>, të cilën Kurani i Shenjtë e përmend edhe diku tjetër duke thënë: “*Trazira është shfaqur në tokë, e në det*” (30:42). Por, lutjet e netëve të errëta të të përhumburit pas Allahut shkaktuan agimin, pra zbritjen e Kuranit të Shenjtë, drita e të cilit do të mbetet deri në Ditën e Kiametit. Një kuptim i fjalëve “derisa të zbardhet agimi” është që zbritja e Shpalljes Kuranore do të vijojë deri në zbardhjen e plotë të agimit. Më pas, kjo sure pohon që çasti i kësaj Nate të Kadrit, nëse dikush e gjen atë, është më e mirë se e gjithë jeta e tij.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithë-mëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Pa dyshim, Ne e zbritëm atë në Natën e Kadrit.

إِنَّا أَنْزَلْنَاهُ فِي لَيْلَةِ الْقَدْرِ ②

3. E si mund ta dish ti se ç'është Nata e Kadrit?!

وَمَا أَدْرَاكَ مَا لَيْلَةُ الْقَدْرِ ③

4. Nata e Kadrit është më e mirë se një mijë muaj.

لَيْلَةُ الْقَدْرِ خَيْرٌ مِنْ أَلْفِ شَهْرٍ ④

5. Në të zbresin engjëjt dhe Shpirti i Shenjtë me urdhrin e Zotit të tyre, në çdo çështje.

تَنْزِيلَ الْمَلَائِكَةِ وَالرُّوحِ فِيهَا بِإِذْنِ رَبِّهِمْ ⑤  
 مِنْ كُلِّ أَمْرٍ ⑥

6. Paqe. Kjo vijon deri në agim.

سَلَامٌ هِيَ حَتَّىٰ مَطْلَعِ الْفَجْرِ ⑦



## Surja 98 – El-Bejjine

Surja El-Bejjine është medinase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka nëntë ajete.

Surja e mëparshme tregoi që shpallja që zbret gjatë Natës së Kadrit zbardh çdo gjë, pra zbulon të gjitha çështjet. Kjo sure pohon që edhe Profetët e mëparshëm patën Natën e tyre të Kadrit, ndonëse në përmasa më të vogla, sepse përndryshe, ata vetë me përpjekjet e veta nuk mund t'i largonin dot errësitat e kohës.

Pas kësaj, për Profetin Muhammed<sup>savs</sup> është pohuar që mësimet e të gjithë Librave të mëparshëm janë përmbledhur në mësimin që i është zbritur atij, pra, në Kuranin e Shenjtë. Dhe se përmbledhja e mësimëve të tyre është që të adhuronin Allahun e Madhërishëm, duke ia përkushtuar fenë vetëm Atij, të falnin namazin dhe të jepnin zekatin. Kjo është feja që do të qëndrojë përgjithmonë, e cila do t'i mbajë njerëzit në rrugën e qëndrueshme dhe të drejtë.

Pas kësaj, u jepet mohuesve dhe besimtarëve lajmi i përfundimit të keq dhe i përfundimit të mbarë, duke thënë se kur vjen feja e qëndrueshme, çdo njeri është i lirë ta ndjekë atë që ta gëzojë përfundimin e mbarë të jetës së tij, ose ta refuzojë atë për të shkuar drejt përfundimit të keq të tij.

Ajetet:  
9٩٨ سُورَةُ الْبَيْتَةِ  
98. EL-BEJJINE  
MedinaseRukutë:  
1

1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Prej ithtarëve të Librit dhe idhujtarëve, ata që mohuan, kurrsesi nuk do të ndalonin, gjersa u erdhi shenja e qartë;

لَمْ يَكُنِ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ أَهْلِ الْكِتَابِ  
وَالْمُشْرِكِينَ مُنْفَكِينَ حَتَّىٰ تَأْتِيَهُمُ  
الْبَيِّنَةُ ①

3. një i Dërguar prej Allahut (u) lexon skripte të pastërta;

رَسُولٌ مِّنَ اللَّهِ يَتْلُو صُحُفًا مُّطَهَّرَةً ①

4. në të cilat ka mësim të qëndrueshme e që japin qëndrueshmëri.

فِيهَا كُتِبَ قِيمَةٌ ①

5. Dhe ata të cilëve u është dhënë Libri, nuk u përçanë, përveçse kur u erdhi shenja e qartë.

وَمَا تَفَرَّقَ الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ إِلَّا مِنْ  
بَعْدِ مَا جَاءَتْهُمْ الْبَيِّنَةُ ①

6. Dhe atyre nuk u është dhënë ndonjë urdhër përveçse të adhuronin Allahun, duke ia përkushtuar fenë vetëm Atij, duke anuar vetëm tek Ai, të falnin namazin dhe të jepnin zekatin. Dhe kjo pikërisht është feja e qëndrueshme.

وَمَا أُمِرُوا إِلَّا لِيَعْبُدُوا اللَّهَ مُخْلِصِينَ  
لَهُ الدِّينَ حُنَفَاءَ وَيُقِيمُوا الصَّلَاةَ وَيُؤْتُوا  
الزَّكَاةَ وَذَلِكَ دِينُ الْقِيمَةِ ①

7. Sigurisht, prej ithtarëve të Librit dhe idhujtarëve, ata që mohuan, do të jenë në zjarrin e xhehenemit, në të cilin do të mbesin gjatë. Pikërisht këta janë krijesat më të këqija.

إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ أَهْلِ الْكِتَابِ  
وَالْمُشْرِكِينَ فِي نَارِ جَهَنَّمَ خَالِدِينَ فِيهَا  
أُولَٰئِكَ هُمْ شَرُّ الْبَرِيَّةِ ①

8. Sigurisht, ata që besuan dhe bënë të mira, janë krijesat më të mira.

إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ  
أُولَٰئِكَ هُمْ خَيْرُ الْبَرِيَّةِ ①

9. Për ta, shpërblimi te Zoti i tyre janë xhenete të përjetshme, në të cilat rrjedhin lumenj. Në to ata do të jetojnë përgjithmonë. Allahu është i kënaqur me ta dhe ata janë të kënaqur me Atë. Kjo është për atë që i frikësohet Zotit të tij.

جَزَاءُ هُمْ عِنْدَ رَبِّهِمْ جَنَّاتٌ تَجْرِي  
 مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا أَبَدًا  
 رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمْ وَرَضُوا عَنْهُ ذَلِكَ  
 لِمَنْ خَشِيَ رَبَّهُ ۝

## Surja 99 – Ez-Zilzal

Surja Ez-Zilzal [ose Ez-Zelzele] është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka nëntë ajete.

Kjo sure parashikon ndryshime të mëdha që do të ndodhin në ditët e vona, për shkak të të cilave njeriu materialist do të besojë se ai ka shënuar fitore mbi ligjet e natyrës, ndërkohë e vërteta është që në atë kohë, toka do të nxjerrë sekretet e saj me vetë urdhrin e Zotit të Profetit Muhammed<sup>saws</sup>. Ajo do të jetë dita (koha), kur njerëzit do të marrin dënime e shpërblime edhe në rrafshin tokësor, kur do të shohin se përparimet e tyre materiale nuk u kanë sjellë qetësi, por luftëra e përçarje. Andaj, atë ditë, çdo njeri do të korrë shpërblimin ose dënimin e mirësive edhe më të vogla dhe të ligësive edhe më të vogla.

Kjo sure në fillim të saj pohon që toka do të nxjerrë përjashta barrët e saj, dhe në këtë kontekst, në fund, gjithashtu thotë se do të peshohen jo vetëm mirësitë e mëdha apo ligësitë e rënda, por nëse dikush ka bërë një mirësi qoftë sa një grimcë, ai do ta gjejë shpërblimin e saj, dhe po kështu, nëse dikush ka bërë një ligësi qoftë sa një grimcë, edhe ai do ta gjejë ndëshkimin e saj.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithë-mëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Kur toka të tronditet fort me tronditjen e saj;

إِذَا زُلْزِلَتِ الْأَرْضُ زُلْزَالَهَا ①

3. dhe toka të nxjerrë përjashta barrët e saj;

وَأَخْرَجَتِ الْأَرْضُ أَثْقَالَهَا ①

4. dhe njeriu të pohojë: “Ç’i ndodhi asaj?!”;

وَقَالَ الْإِنْسَانُ مَا لَهَا ①

5. ditën kur ajo do të rrëfejë lajmet e saj;

يَوْمَئِذٍ تُحَدِّثُ أَخْبَارَهَا ①

6. sepse Zoti yt do t’ia ketë shpallur asaj;

بِأَنَّ رَبَّكَ أَوْحَى لَهَا ①

7. atë ditë njerëzit do të dalin në grupe të shastisura, që atyre t’u tregohen veprat e tyre.

يَوْمَئِذٍ يَصْدُرُ النَّاسُ أَشْتَاتًا لِّيُرَوْا  
أَعْمَالَهُمْ ①

8. Atëherë, kushdo që bën një të mirë, qoftë sa një grimcë, do ta shohë atë;

فَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ خَيْرًا يَرَهُ ①

9. dhe kushdo që bën një të keqe, qoftë sa një grimcë, do ta shohë atë.<sup>1</sup>

وَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ شَرًّا يَرَهُ ①

1. Ajetet 8-9 pohojnë që njeriu do të shpërblehet jo vetëm për mirësitë më të vogla të tij, por do të ndëshkohet edhe për ligësitë më të vogla të tij. Megjithatë, nuk duhet të harrojmë që koncepti i faljes qëndron më lart se parimi që është përmendur në këtë sure. Kurani i Shenjtë na tregon që Allahu i Madhërishëm, nëse do, mund të falë edhe mëkatet më të mëdha të njeriut, sepse Ai ia di zemrën, dhe di shumë mirë se cilët meritojnë faljen prej Tij.

## Surja 100 – El-Adijat

Surja El-Adijat është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka dymbëdhjetë ajete.

Pas përmendjes së luftërave që do të bëhen për hir të botës materiale, në këtë sure, Zoti i Madhërisëm na rikujton luftërat vetëmbrojtëse që ndërmorën Profeti Muhammed<sup>savs</sup> dhe sahabët e tij, luftëra të cilat ishin tërësisht të kundërta nga luftërat e botës materiale, si në synimin e tyre, ashtu edhe në përfundimin e tyre. Zoti i Madhërisëm solli si dëshmi kalorës të shpejtë që me frymëmarrje të shpejtë i vërsulen armikut, duke nxjerrë shkëndija me patkonjtë e kuajve të tyre; ata bëjnë sulmin në mëngjes dhe nuk sulmojnë gjatë natës. Kjo njëherësh është edhe shenjë e trimërisë së tyre të jashtëzakonshme, sepse ata që luftojnë për botën materiale gjithmonë tentojnë të sulmojnë natën ose fshehurazi.

Më pas tha, njeriu është mosmirënjohës i madh ndaj Zotit të tij dhe për këtë ai vetë është dëshmitar. Ai bëhet tepër i ashpër në dashurinë për paratë. Kjo tregon edhe faktin që luftërat e botës materiale bëhen për pasuri. Kjo sure i bën thirrje njeriut të tillë – A nuk e di ai që toka do të zbulojë të gjitha sekretet e saj?! Po kështu, të gjitha fjalët që janë të fshehura në kraharorët gjithashtu do të dalin në shesh, sepse Allahu i Madhërisëm është i Gjithinformuar për punët e tyre.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithë-mëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Beto hem për kuajt që vrapojnë me shpejtësi duke diatur!

وَالْعَدِيَّتِ صَبْحًا ①

3. Dhe për nxjerrësit e shkëndijave nga fërkimi!

فَأَمْوَرٍ قَدْحًا ①

4. Dhe për sulmuesit në mëngjes!

فَأَمْغِيزَتِ صَبْحًا ①

5. E përmes atij (sulmi) ata ngrenë një re pluhuri.

فَأَثَرَنَ بِهِ نَفْعًا ①

6. Përmes së cilës ata hidhen brenda një grupi (të armikut).

فَوَسَطْنَ بِهِ جَمْعًا ①

7. Pa dyshim, njeriu është shumë mosmirënjohës ndaj Zotit të tij.

إِنَّ الْإِنْسَانَ لِرَبِّهِ لَكَنُودٌ ①

8. Dhe, pa dyshim, ai vetë është dëshmitar për këtë.

وَأَنَّهُ عَلَىٰ ذٰلِكَ لَشَهِيدٌ ①

9. Dhe, pa dyshim, ai është fort i dashuruar me pasurinë.

وَأَنَّهُ لِحُبِّ الْخَيْرِ لَشَدِيدٌ ①

10. A nuk e di ai se kur do të nxirret ajo që është në varre?!

أَفَلَا يَعْلَمُ إِذَا بُعْثِرَ مَا فِي الْقُبُورِ ①

11. dhe do të arrihet ajo që është në kraharorë?!

وَحُصِّلَ مَا فِي الصُّدُورِ ①

12. Pa dyshim, atë ditë Zoti i tyre do të jetë i Gjithinformuar për ta.

يَعْلَمُ إِنَّ رَبَّهُمْ بِهِمْ يَوْمَئِذٍ لَّخَبِيرٌ ①

## Surja 101 – El-Karia

Surja El-Karia është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka dymbëdhjetë ajete.

Edhe kjo sure përsërit paralajmërimin që u bë në suren paraardhëse, duke thënë se një zë i llahtarshëm do të trokasë herë pas here në derën e njeriut [fjala *ker'e* që është rrënja e emrit të kësaj sureje, do të thotë trokitje]. Çfarë është kjo trokitje? Mendoni sërish se çfarë është kjo trokitje! Mendoni për kohën kur njerëzit do të shpërndahen për shkak të pasojave të mëdha të luftërave të tmerrshme, madje, edhe malet do të tronditen dhe do të bëhen, si të thuash, si lesh i lënurur. Malet këtu gjithashtu nënkuptojnë superfuqitë e kohës. Nëse këto ajete i aplikojmë për këtë botë, shkërmoqja e maleve nënkupton shkatërrimin e superfuqive. Ato që do të kenë armatimet më të rënda, do t'i mundin ato që nuk i zotërojnë të tillat, dhe këto të fundit, do të bien në gropën e ndëshkimit të luftërave, që do të jetë një zjarr i vërtetë.





1. Me emrin e Allahut, të Gjithë-  
mëshirshmit, Mëshirëbërësit. بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①
2. Gjëmimi! الْقَارِعَةُ ①
3. Çfarë është gjëmimi? مَا الْقَارِعَةُ ②
4. E si mund ta dish ti se ç'është  
gjëmimi?! وَمَا أَذْرَبِكَ مَا الْقَارِعَةُ ③
5. Ditën kur njerëzit do të jenë si  
kandrra të përndara. يَوْمَ يَكُونُ النَّاسُ كَالْفَرَاشِ الْمَبْثُوثِ ④
6. Dhe malet do të jenë porsi lesh i  
shprishur. وَتَكُونُ الْجِبَالُ كَالْعِهْنِ الْمَنْفُوشِ ⑤
7. Atëherë ai që peshat do t'i ketë të  
rënda, فَأَمَّا مَنْ ثَقُلَتْ مَوَازِينُهُ ⑥
8. do të jetë në një jetë të kënaqur. فَهُوَ فِي عِيشَةٍ رَاضِيَةٍ ⑦
9. Kurse ai që peshat do t'i ketë të  
lehta, وَأَمَّا مَنْ خَفَّتْ مَوَازِينُهُ ⑧
10. nëna e tij do të jetë *havije*. فَأُمُّهُ هَاوِيَةٌ ⑨
11. E si mund ta dish ti se ç'është  
ajo?! وَمَا أَذْرَبِكَ مَا هِيَ ⑩
12. (Ajo është) një zjarr i flakëruar!<sup>1</sup> نَارٍ حَامِيَةٍ ⑪

1. Siç e thamë në parathënie që temat e kësaj sureje aplikohen edhe në këtë botë, pra, për luftëra të mëdha që do të ndodhin, po kështu ato aplikohen edhe për Ditën e Kiametit. Pra, atyre që do t'u rëndojë peshorja më shumë me veprat e mira, ata do të jenë në xhenet ku do të kenë jetë të lumtur. Kurse ata të cilëve do t'u rëndojë peshorja me veprat e këqija, do të dënohen në zjarrin e xhehenemit.

## Surja 102 – Et-Tekathur

Surja Et-Tekathur është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka nëntë ajete.

Kjo sure paralajmëron njeriun se etja e tij për të shtuar paratë sa më shumë, do ta shpjerë atë në varr. Kjo nga njëra anë është një thirrje e fortë për popujt e fuqishëm që gara e tyre për pushtet e pasuri, nuk do t'i çojë asgjekund përveçse në shkatërrim. Po kështu, kjo thirrje mund të interpretohet edhe për disa popuj të vegjël të cilët me shpresën për të gjetur paratë e pasuritë, nuk do të lënë pa shfrytëzuar edhe vizitën nëpër varre. Dy herë paralajmërimi që i është bërë njeriut, duket se e ka një arsye. Janë paralajmëruar si popujt materialistë, ashtu edhe popujt fetarë që ndjekin besëtytni e fiksime, se në fund ata do të njihen me zjarrin që është ndezur pikërisht për ta. Kështu që, u thuhet – Ju do ta shikoni atë me sy, dhe pasi do të hidheni në të, do të pyeteni se çfarë ju ka sjellë babëzia juaj për begatitë tokësore!



1. Me emrin e Allahut, të Gjithë-  
mëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Gara për pasuri ju ka shkatërruar,

أَلْهَكُمُ التَّكَاثُرُ ②

3. sa edhe në varre shkuat!

حَتَّىٰ زُرْتُمُ الْمَقَابِرَ ③

4. Dëgjoni! Së shpejti do ta kuptoni.

كَلَّا سَوْفَ تَعْلَمُونَ ④

5. Sërish dëgjoni! Së shpejti do ta  
kuptoni.

ثُمَّ كَلَّا سَوْفَ تَعْلَمُونَ ⑤

6. Dëgjoni! Po ta dini me dijen e  
bindjes,

كَلَّا لَوْ تَعْلَمُونَ عِلْمَ الْيَقِينِ ⑥

7. patjetër do ta shikoni xhehenemin.

لَتَرَوُنَّ الْجَحِيمَ ⑦

8. Dhe atëherë patjetër do ta shikoni  
atë me syrin e bindjes.

ثُمَّ لَتَرَوُنَّهَا عَيْنَ الْيَقِينِ ⑧

9. Dhe atëherë patjetër do të pyeteni  
atë ditë për bekimet.

لَعَلَّكُمْ لَتُسْأَلُنَّ يَوْمَئِذٍ عَنِ النَّعِيمِ ⑨

### Surja 103 – El-Asr

Surja El-Asr është zbritur në periudhën e hershme mekase dhe, bashkë me *bismillahin*, ka katër ajete.

Surja paraardhëse paralajmëroi disa lloje njerëzish të cilët e kërkojnë babëzisht botën materiale. Kjo sure pohon se për shkak të njerëzve të tillë, do të vijë një kohë, kur vetë koha do të dëshmojë që njeriu është në humbje, përveç atyre që besuan, bënë të mira, dhe që iu përmbajtën së vërtetës dhe për këtë këshilluan edhe të tjerët. Po kështu, ata iu përmbajtën durimit dhe për këtë i këshilluan edhe të tjerët.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithë-  
mëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Beto hem për kohën!

وَالْعَصْرِ ①

3. Pa dyshim, njeriu është në  
humbje.

إِنَّ الْإِنْسَانَ لَفِي خُسْرٍ ①

4. Përveç atyre që besuan, bënë të  
mira, këshilluan njëri-tjetrin për të  
vërtetën duke iu përmbajtur asaj  
edhe vetë, dhe këshilluan njëri-  
tjetrin për durim duke iu përmbajtur  
edhe vetë.

إِلَّا الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ

ۚ وَتَوَاصَوْا بِالْحَقِّ وَتَوَاصَوْا بِالصَّبْرِ ①

## Surja 104 – El-Humeze

Surja El-Humeze është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka dhjetë ajete.

Pas sures El-Asr vjen surja El-Humeze. Ndër të gjitha paralajmërimet që deri më tani u janë dhënë njerëzve që lakmojnë vetëm botën materiale, kjo sure bën paralajmërimin më të fortë. Kjo sure bën profeci duke thënë: Njeriu “i fortë” i kohës së vonshme do të mendojë se ka mbledhur pasuri të madhe, të cilën ai do ta shpenzojë kaq shumë për mbrojtjen e vet, sa që do të ndiejë veten me një hegjemoni të pavdekshme. Por do të ndodhë e kundërta! Ai do të hidhet në *hutame*, pra, në një zjarr që do të jetë i mbyllur në grimcat më të vogla. E si mund ta dish ti se ç’zjarr është ky?!

Kjo pyetje vjen e natyrshme, sepse askush nuk mund të konceptonte dot se si mund të mbyllet zjarri në grimca të vogla. Por ky zjarr është ai që është i kyçur në atome. Edhe fjalët *hutam* dhe *atom* sa afër tingëlluakan! Ky është ai zjarr që do të sulmojë befasisht zemrat. Dhe për këtë sulm ndaj tyre, ai është i kyçur në disa shtylla, të cilat do të zgjaten në momentin e shpërthimit.

Për ta kuptuar këtë sure, lexuesi duhet ta dijë procesin që ndodh gjatë shpërthimit të një bombe atomike. Lënda në të cilën është i kyçur ky “zjarr atomik”, përpara se të shpërthejë merr pamjen e kolonave të zgjatura. Pra, për shkak të presionit gjithnjë në rritje, formohen kolonat dhe ato vijojnë të zgjaten. Ky zjarr është i tillë që përpara se t’i djegë trupin njeriut, ia godet zemrën në mënyrë fatale. Sipas shkencëtarëve kjo është pikërisht ajo që ndodh me shpërthimin e një bombe atomike. Përpara se të arrijnë rrezet që djegin trupin dhe gjithçka, valët radioaktive të bombës atomike godasin zemrat e njerëzve, duke ua marrë jetën.

Ka edhe një kuptim tjetër të kësaj sureje: një zjarr është i fshehur në grimcat e trupit të njeriut, i cili kur të lëshohet, do ta sulmojë zemrën e njeriut duke e sakatuar krejtësisht.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithë-mëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. U shkatërroftë çdo përgojues (dhe) shpifës,

وَيْلٌ لِّكُلِّ هُمَزَةٍ لُّمَزَةٍ ①

3. që grumbulloi pasuri dhe e numëroi atë.

الَّذِي جَمَعَ مَالًا وَعَدَّدَهُ ①

4. Ai mendon se pasuria e tij do t'i japë përjetësi.

يَحْسَبُ أَنَّ مَالَهُ أَخْلَدَهُ ①

5. Përkundrazi! Ai patjetër do të hidhet në *hutame*.

كَلَّا لَيُنْبَذَنَّ فِي الْحُطَمَةِ ①

6. E si mund ta dish ti se ç'është *hutame*?

وَمَا أَدْرَاكَ مَا الْحُطَمَةُ ①

7. (Ajo) është zjarri i Allahut, i ndezur fort,

نَارُ اللَّهِ الْمَوْقُودَةُ ①

8. që arrin (befasisht) në zemra.<sup>1</sup>

الَّتِي تَطَّلِعُ عَلَى الْأَفْئِدَةِ ①

9. Pa dyshim, ai (zjarr) kundër tyre është i mbyllur;

إِنَّهَا عَلَيْهِمْ مُّوَصَّاةٌ ①

10. në kolona të zgjatura.

عِجٌّ فِي عَمَدٍ مُّمَدَّدَةٍ ①

1. Përveç kuptimeve që janë dhënë në parathënie, kjo sure interpretohet edhe në aspektin shpirtëror. Jeta e xhenetit fillon që në këtë botë, po kështu, edhe jeta e ferrit. Siç e shpjegojnë këto ajete që xhehenemi është ai zjarr, që e ka burimin te mospëlqimi i Allahut, pra që lind nga mëkati, dhe ky zjarr së pari e sulmon zemrën. Kështu, ky ajet tregon se vatra e këtij zjarri përbëhet nga brought dhe dëshpërimet që e kaplojnë njeriun. Të gjitha kënaqësitë gjithashtu zënë fill në zemër. Të gjitha kënaqësitë gjithashtu zënë fill në zemër. Kështu, pikërisht zemra është burimi i besimit, ose i mohimit. Andaj, qoftë besimi, qoftë mohimi, së pari mbin në zemër dhe më pas përhapet në të gjithë trupin e tij. Dhe pikërisht këtë gjendje njeriu e mbart në botën tjetër, mbi bazën e së cilës, ai do të shikojë xhenetin ose xhehenemin e tij.

## Surja 105 – El-Fil

Surja El-Fil është zbritur në periudhën e hershme mekase dhe, bashkë me *bismillahin*, ka gjashtë ajete.

Zhvillimi i popujve materialistë do të arrijë kulmin përfundimtar në pikën kur ata bashkërisht do të bëjnë përpjekje të mëdha për ta asgjësuar Islamin. Duke treguar një ngjarje të së kaluarës, Kurani i Shenjtë deklaron që edhe më përpara superfuqitë e kohës tentuan ta shkatërrojnë Mekën, *amën e vendbanimeve*. Ata ishin të zotët e elefantëve, por përpara se ata të arrinin në Mekë me elefantët e tyre gjigantë, zogjtë *ebabil* që ndërtojnë çerdhet nëpër zgavra shkëmbinjsh, u lëshuan gurëza të atilla që kishin mikrobe, të cilat shkaktuan epidemi të një lloji lie. Sëmundja vdekjeprurëse u përhap me shpejtësi në të gjithë ushtrinë, duke i kthyer trupat ushtarake në trupa të vdekur, të lënë si mbeturina. Zogjtë që hanë ngordhësirën, vinin dhe godisnin pjesët e trupave të tyre nëpër tokë. Kështu që, edhe në të ardhmen, nëse ndonjë popull apo shtet, nisur nga fuqia e tij, do të ndërmarrë çnderimin ose shkatërrimin e Mekës, ai vetë do të shkatërrohet po në këtë mënyrë.





1. Me emrin e Allahut, të Gjithë-mëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ۝

2. A nuk e pe se çfarë bëri Zoti yt me Njerëzit e Elefantit?!

أَلَمْ تَرَ كَيْفَ فَعَلَ رَبُّكَ بِأَصْحَابِ  
الْفِيلِ ۝

3. A nuk ua shkatërroi strategjinë?!

أَلَمْ يَجْعَلْ كَيْدَهُمْ فِي تَضْلِيلٍ ۝

4. Dhe u dërgoi zogj tufa-tufa?!

وَ أَرْسَلَ عَلَيْهِمْ طَيْرًا أَبَابِيلَ ۝

5. Ata u gjuanin gurëza prej dheu të thatë.

تَرْمِيهِمْ بِحِجَارَةٍ مِّن سِجِّيلٍ ۝

6. Atëherë, Ai i bëri porsi sanë e përtypur.

فَجَعَلَهُمْ كَعَصْفٍ مَّأْكُولٍ ۝

## Surja 106 – Kurejsh

Surja Kurejsh është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka pesë ajete.

Pas ngjarjes së elefantëve, mekasit udhëtonin në verë e në dimër me karvanë tregtarë, duke iu siguruar banorëve çdolloj frute, dhe duke iu mundësuar ushqim dhe paqe. Surja Kurejsh pas sures El-Fil tregon që njësoj do të ndodhë edhe në të ardhmen.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithë-mëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Për të bashkuar kurejshët,

لَا يَأْتِيَنَّكُمْ قُرَيْشٌ ②

3. (pikërisht) për t'i bashkuar ata, u organizuan udhëtimet në dimër e verë.

الْفِهِمُ رِحْلَةَ الشِّتَاءِ وَالصَّيْفِ ③

4. Andaj, ata duhet ta adhurojnë Zotin e kësaj Shtëpie,

فَلْيَعْبُدُوا رَبَّ هَذَا الْبَيْتِ ④

5. (Zot), i cili i shpëtoi nga uria duke i ushqyer, dhe (i cili) u dha siguri (edhe) nga frika.

الَّذِي أَطْعَمَهُمْ مِنْ جُوعٍ وَآمَنَهُمْ مِنَ ⑤

الْحَوْفِ ⑤

## Surja 107 – El-Maun

Surja El-Maun është zbritur në periudhën e hershme mekase dhe, bashkë me *bismillahin*, ka tetë ajete.

Surja e mëparshme përmendi *bollëkun*. Kurse kjo sure përmend mësimin, të cilin Allahu ua jep muslimanëve të atyre kohërave se kur Ai do t'i begatojë *me bollëk*, ata nuk duhet të ngurrojnë të shpenzojnë pasurinë e tyre në rrugën e Zotit, që vetë Ai ua ka dhuruar, dhe nuk duhet të bëjnë adhurimin e Zotit sa për sy e faqe, por ta bëjnë me sinqeritet të plotë, siç ua ka mësuar Zoti i Qabes. Kjo mund të jetë një lidhje midis dy sureve. Por duket se do të ndodhë ajo që është e parashikuar. Shumë prej tyre do të falin namazet sa për sy e faqe, dhe për këtë arsye, vetë namazet e tyre do të bëhen shkak i shkatërrimit të tyre. Po kështu, edhe shpenzimet e tyre do të jenë vetëm për reklamë. Gjendja e tyre do të jetë e tillë sa që ata do të bëjnë shpenzime marramendëse për t'i siguruar vetes nam e famë, kurse për t'iu siguruar nevojtarëve dhe të varfërve gjërat më elementare, do të hezitojnë të shpenzojnë.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithë-mëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ۝

2. A ke menduar për atë që mohon fenë?

أَرَأَيْتَ الَّذِي يَكْذِبُ بِاللَّيْنِ ۝

3. Pikërisht ai përzë jetimin;

فَذَلِكَ الَّذِي يَدْعُ الْيَتِيمَ ۝

4. dhe nuk nxit (të tjerët) për të ushqyer nevojtarin.

وَلَا يَحْضُ عَلَى طَعَامِ الْمُسْكِينِ ۝

5. Andaj, u mjerofshin namazfalësit,

فَوَيْلٌ لِلْمُصَلِّينَ ۝

6. të cilët janë të shkujdesur ndaj namazeve të tyre;

الَّذِينَ هُمْ عَنْ صَلَاتِهِمْ سَاهُونَ ۝

7. të cilët vetëm shtiren;

الَّذِينَ هُمْ يُرَاءُونَ ۝

8. dhe ndalojnë (edhe) nevojat më elementare.

وَيَمْنَعُونَ الْمَاعُونَ ۝

## Surja 108 – El-Keuther

Surja El-Keuther është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka katër ajete.

Pas sures El-Maun, Zoti i Madhërishëm i jep Profetit Muhammed<sup>savs</sup> lajmin e mirë që atij do t'i dhurojë *keutherin*, diçka me kaq bollëk që kurrë nuk do të shterojë. Një kuptim i kësaj janë pasuritë që Profeti dhe besimtarët do të shpenzojnë pa frikë në rrugën e Zotit dhe se Zoti do t'ua shtojë edhe më shumë. Një kuptim tjetër i *keutherit* është edhe Kurani i Shenjtë. Realisht, sihariqi më i madh që Allahu i ka dhënë Profetit<sup>savs</sup> është pikërisht Kurani i Shenjtë, temat e të cilit nuk do të shterojnë kurrë, dhe ky Libër do të vijojë t'i sjellë dobi njerëzimit deri në Kiamet. Askush nuk do të mund t'i përmbledhë temat e këtij Libri të Shenjtë.

Më pas, Zoti i Madhërishëm e porosit Profetin<sup>savs</sup>: Adhuro Zotin dhe sakrifiko duke e falënderuar Atë për bekimin e madh që Ai të dha; sigurisht, armiku yt do të mbetet farësosur, kurse bekimet e tua kurrë nuk do të sosen.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Pa dyshim, Ne të dhuruam *Keutherin*.<sup>1</sup>

إِنَّا آعْطَيْنَاكَ الْكُوثَرَ ①

3. Andaj, fal namazin për hir të Zotit tënd dhe (po për hir të Tij) bëj kurban.

فَصَلِّ لِرَبِّكَ وَأَنْحِرْ ①

4. Pikërisht armiku yt do të mbetet farësosur.<sup>2</sup>

إِنَّ شَانِئَكَ هُوَ الْأَبْتَرُ ①

1. Sipas fjalorit *keuther* do të thotë (1) bollëk i të mirave, (2) udhëheqës që zotëron të mira të shumta, (3) njeri bujar që dhuron shumë dhe shpesh (Akrab). Në hadith gjithashtu përmendet se në xhenet është një lumë i veçantë që quhet *Keuther* (Buhari, nr. 4964).

2. Mohuesit mekas e ironizonin Profetin Muhammed<sup>savs</sup> duke thënë se ai është farësosur, pra një njeri që nuk ka një pasardhës mashkull. Kurse Allahu i Madhërishëm i dha lajmin – Vetë armiku yt do të mbetet farësosur. Kjo nënkupton që pasardhësit meshkuj të mohuesve mekas do të krijonin lidhje shpirtërore me Profetin<sup>savs</sup>, duke shkëputur lidhjen me baballarët e tyre fatligë. Kjo ishte një profeci që u përmbush fjalë për fjalë. Ikremeja<sup>ra</sup> i biri i Ebu Xhehlit, për shembull, e pranoi Islamit. Një herë dikush e ironizoi se ai që i biri i Ebu Xhehlit, gjë që e mërzi Ikremenë, dhe ai iu ankua Profetit<sup>savs</sup>. I Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> porositi – Më mos e thirrni Ikremenë si i biri i Ebu Xhehlit! (*Usdul-Gabeh* nën emrin Ikreme). Me një fjalë, Ebu Xhehli vdiq dhe mbeti farësosur, kurse pasardhësit e tij krijuan lidhje shpirtërore me Profetin Muhammed<sup>savs</sup>.

## Surja 109 – El-Kafirun

Surja El-Kafirun është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka shtatë ajete.

Në këtë sure, Zoti i Madhërishëm porositi Profetin<sup>savs</sup> dhe çdo musliman që t'i qartësojë mohuesit: As unë nuk do të ndjek ndonjëherë fenë tuaj, e as ju fenë time; andaj, ju vazhdoni fenë tuaj, e unë timen.





1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Thuaj: O mohues!

قُلْ يَا أَيُّهَا الْكَافِرُونَ ①

3. Unë nuk e adhuroj atë që adhuroni ju.

لَا أَعْبُدُ مَا تَعْبُدُونَ ①

4. E as ju nuk jeni adhurues të Atij që adhuroj unë.

وَلَا أَنْتُمْ عِبُدُونَ مَا أَعْبُدُ ①

5. Dhe unë as nuk do ta adhuroj ndonjëherë atë që adhuroat ju.

وَلَا أَنَا عَابِدٌ مَّا عَبَدْتُمْ ①

6. Dhe as ju nuk do të jeni adhurues të Atij që adhuroj unë.

وَلَا أَنْتُمْ عِبُدُونَ مَا أَعْبُدُ ①

7. Ju keni fenë tuaj, e unë kam fenë time.

لَكُمْ دِينُكُمْ وَلِيَ دِينِ ①

## Surja 110 – En-Nasr

Surja En-Nasr është medinase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka katër ajete.

Kjo sure në njëfarë mënyre tregon një aspekt tjetër të *keutherit*. Pra, ashtu siç kuptimet e Kuranit nuk do të sosen, në të njëjtën mënyrë edhe fitoret e Islamit janë të pasosura. Patjetër do të vijë koha kur popujt grupe-grupe do të hyjnë në fenë Islame. Por kjo kohë nuk do të jetë për të shpallur gëzime të potershme, përkundrazi, për t'i kërkuar falje Zotit (*istigfar*), në mënyrë që fitoret të mos shkaktojnë mendjemadhësi te muslimanët. Fitoret duhet t'i bëjnë edhe më të përulur dhe, edhe më të bindur në faktin se kjo ndodhi vetëm falë bekimit të Allahut. Andaj, në një kohë të tillë, besimtari duhet të bëjë *istigfar* më shumë se përpara dhe duhet ta lartësojë Allahun e Madhërishëm më shumë se përpara.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithë-  
mëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Kur të vijë ndihma e Allahut dhe  
fitorja,

إِذَا جَاءَ نَصْرُ اللَّهِ وَالْفَتْحُ ②

3. dhe ti do t'i shohësh njerëzit tek  
hyjnë grupe-grupe në fenë e Allahut!

وَرَأَيْتَ النَّاسَ يَدْخُلُونَ فِي دِينِ اللَّهِ  
أَفْوَاجًا ③

4. Atëherë përkujto Zotin tënd me  
lavdërimin (e Tij) dhe kërkoji falje  
Atij. Pa dyshim, Ai është shumë  
Pendimpranues.

فَسَبِّحْ بِحَمْدِ رَبِّكَ وَاسْتَغْفِرْهُ ④ إِنَّهُ كَانَ  
تَوَّابًا ⑤

## Surja 111 – El-Leheb

Surja El-Leheb është zbritur në periudhën e hershme mekase dhe, bashkë me *bismillahin*, ka gjashtë ajete.

Ebu Lehebi ishte njëri nga xhaxhallarët e Profetit Muhammed<sup>savs</sup>. Ai përhapte kudo vetëm zjarrin e urrejtjes kundër Profetit<sup>savs</sup> dhe, edhe gruaja e tij e ndihmonte në këtë përpjekje. Zoti i Madhërishëm tha – Atij do t'i priten të dyja duart. Kjo profeci nuk ishte vetëm për Ebu Lehebin. Edhe në të ardhmen, të gjithë ata që do të përhapin shkëndija lufte kundër Islamit, qofshin me dorën e tyre të majtë, qofshin me të djathtën, nuk do të korrin asgjë tjetër përveç poshtërimit. Kurse popujt vartës të tyre, të cilët, pors i gruaja e Ebu Lehebit, do t'i ndihmojnë duke grumbulluar lëndë djegëse për ta ndezur zjarrin kundër Islamit, nuk do të kenë asnjë fat përveç varjes në litar.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ ۝۱

2. Iu thafshin duart Ebu Lehebit dhe u shkatërroftë (edhe) ai!

تَبَّتْ يَدَا اِبْنِ لَهَبٍ وَتَبَّ ۝۲

3. Nuk e ndihmoi dot aspak as pasuria e tij, e as ajo që ai ka fituar.

مَا اَعْنٰی عَنْهُ مَالُهُ وَمَا كَسَبَ ۝۳

4. Ai do të hidhet pashmangshëmrisht në një zjarr të flakëruar.

سَيَصْلٰی نَارًا اذَاتَ لَهَبٍ ۝۴

5. Edhe gruaja e tij, si mbartëse e lëndës djegëse,

وَ اَمْرَاتُهُ حَمَّالَةَ الْحَطَبِ ۝۵

6. do të ketë në qafën e saj një litar me fije të përdredhura palme.

۝۶ فِیْ جِیْدِهَا حَبْلٌ مِّنْ مَّسَدٍ ۝۶

## Surja 112 – El-Ihlas

Surja El-Ihlas është mekase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka pesë ajete.

Është një sure shumë e shkurtër, por që premtori fitore madhështore të së ardhmes, që Islami do të ketë mbi fenë e krishterë. Allahu as nuk ka pasur ndonjë baba, dhe as nuk ka ndonjë bir. Kjo fjali e shkurtër e rrëzon gjithë ngrehinën e fesë së krishterë. Pra, derisa Zoti nuk ka ndonjë baba, si i lindi nevoja për të bërë një djalë?! Po kështu, edhe Jezusi<sup>as</sup>, për të cilin të krishterët pretendojnë se është “i biri i Zotit”, pse nuk i trashëgoi dot aftësitë e “të atit”?! Nëse “i ati” bëri “djalë”, pse nuk lindën më tej fëmijët e tjerë?! Pas kësaj, Allahu tha: Askush nuk është i barabartë me Allahun e Madhërishtëm. Andaj, besimi që Zoti *ma’adhAllah* ka bërë fëmijë etj., shkakton vetëm mosrespektim të Zotit dhe asgjë më shumë.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithë-mëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Thuaj: Ai është Allahu, i Vetmi.

قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ ②

3. Allahu është i Pavaruri.

اللَّهُ الصَّمَدُ ③

4. Ai nuk ka lindur (askënd) dhe as nuk është i lindur.

لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ ④

5. Dhe askush nuk ka qenë asnjëherë i barabartë me Të.<sup>1</sup>

لَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ ⑤

1. Shikoni se me çfarë mjeshtërie dhe me çfarë bukurie kjo sure e shkurtër tregon patëmetësinë e Zotit, duke përshkruar pastërtinë e Tij nga çdolloj *shirku!* Logjikisht *shirku*, pra të barazuarit ose ortakëria e dikujt a diçkaje me Zotin, mund të bëhet në katër forma: *shirku* në numër, *shirku* në status, *shirku* duke sajuar trashëgimtar a farefis të Zotit dhe *shirku* në vepra apo në ndikimin e ndonjë vepre të caktuar. Kjo sure e përshkruan Zotin të pastër nga të katër llojet e *shirkut*. Pohon qartazi se Ai është i Vetmi dhe se nuk ka dy a tre a shumë zota. Pastaj thotë se Ai është *Es-Samed*, d.m.th. në status Ai është i Vetëmjaftueshëm dhe i Pavarur dhe përveç Tij, gjithçka tjetër është krijesë, e vdekshme dhe në çdo çast varet prej Tij. Pastaj tha se Ai nuk ka bir, i cili për shkak të lidhjes së birësisë, të mund të pretendonte barazinë me Të, dhe shtoi se as dikush tjetër nuk është babai i Tij, i cili për shkak të lidhjes së atësisë, të mund të pretendonte barazinë me Të. Pastaj tha se as në punët e Tij nuk ka ndonjë bashkëpunëtor, i cili për shkak të bashkëpunimit, të mund të pretendonte barazinë me Të. Në këtë mënyrë, kjo sure e nxjerr të pastër Zotin e Madhërisshëm nga të katërta llojet e *shirkut* dhe provon se Ai është i Vetëm, pa asnjë ortak.

## Surja 113 – El-Felek

Surja El-Felek është medinase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka gjashtë ajete.

Në këtë sure Zoti i Madhërishëm na paralajmëroi se në çdo krijim të Tij, përveç së mirës, ka edhe të keqe, prej së cilës, përmes Allahut duhet të mbroheni. Po kështu, kërkojini mbrojtje Allahut nga nata që do ta pushtojë botën edhe një herë tjetër. Kërkojini mbrojtje Allahut nga njerëzit që ndajnë e përçajnë njerëzit e tjerë. Si të thuash, parimi i tyre do të jetë “Përçaji dhe sundoji!”. Kjo është edhe esenca e imperializmit, i cili do ta pushtonte botën. Por pavarësisht nga kjo, Islami sërish do të përparojë, saqë kundërshtarët do të mbeten ziliqarë ndaj tij. Koncepti i zilisë së tyre që tregon kjo sure, përbën një profeci në vetvete, që Islami do të vijojë të përparojë, dhe zilia e armikut do të vijojë të shtohet.





1. Me emrin e Allahut, të Gjithë-mëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①

2. Thuaj: Kërkoj mbrojtjen e Zotit të agimit;

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ ②

3. nga e keqja e asaj që Ai krijoi;

مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ ③

4. nga e keqja e errësuesit kur sjell errësirë;

وَمِنْ شَرِّ غَاسِقٍ إِذَا وَقَبَ ④

5. nga e keqja e atyre që fryjnë në nyje;

وَمِنْ شَرِّ النَّفَّاثَاتِ فِي الْعُقَدِ ⑤

6. dhe nga e keqja e ziliqarit kur shfaq zili.<sup>1</sup>

وَمِنْ شَرِّ حَاسِدٍ إِذَا حَسَدَ ⑥

1. Vërejmë se kjo sure trajton faktorët e jashtëm që ndikojnë në jetën e njeriut, kurse surja pasardhëse trajton anën shpirtërore të saj. Njeriu përballet me rreziqe dhe vështirësi të ndryshme në jetë. Kur ai është i angazhuar në një projekt të rëndësishëm, veçanërisht në përhapjen e dritës së të Vërtetës, forcat e errësirës e rrethojnë nga të gjitha anët. Kur ai tregon qëndresë dhe vazhdon më tej, njerëzit e ligj i krijojnë lloj-lloj pengesash e vështirësish. Kur përfundimisht ai e arrin suksesin, ziliqarët tentojnë ta privojnë atë nga fryti i punës së tij. Andaj, Kurani e porosit besimtarin që vetëm Allahu është Zoti i agimit, andaj Atij t'i kërkojë ndihmë që Ai t'i mundësojë dritë kur ka errësirë përreth; që Ai ta mbrojë atë nga planet e liga të keqbërësve dhe gjithashtu nga kurthet e ziliqarëve. Kështu, kjo lutje e shkurtër i përshkruan me mjeshtëri dhe me elokuencë mbresëlënëse të tria fazat e një pune të rëndësishme. Për fat të keq, shumë muslimanë këto sure të rëndësishme i lexojnë thjesht për të larguar magjinë a xhindët, siç i përfytyrojnë ata vetë, duke pohuar se gjoja edhe Profetit<sup>savs</sup> i kanë bërë magji, *ma'adhallah*, dhe Allahu ia ka mësuar këto dy suret e fundit për ta larguar atë. Në të vërtetë, këto tri sure janë një përmbledhje e Kuranit dhe përbëhen nga tema shumë të thella. Profeti<sup>savs</sup> i donte aq shumë, sa që çdo natë kur shtrihej, i bashkonte duart, i shqiptonte tri suret e fundit, më pas e fërkonte trupin e tij me duar. Dhe këtë e bënte tri herë (Buhari, nr. 5017). Për sa i përket “ngjarjes” ku pretendohet që Profetit<sup>savs</sup> t'i kenë bërë magji, është tërësisht e pabesueshme dhe e pavërtetë. Magjia vjen prej djallit dhe Profetët e Zotit gjenden në një pozitë aq të lartë, që ata nuk i prek dot magjia. Madje, ajo ia mbath sapo t'i shohë ata, siç thotë Zoti: “... *magjistari nuk ka sukses, ngado që të vijë.*” (20:70). Vetëm të mendosh se Profeti<sup>savs</sup> qenka prekur nga magjia, të ikën besimi. Zoti thotë: “... *keqbërësit thonë: “Ju ndiqni vetëm një njeri të magjepsur!”*” (17:48). Pra, ata që pohojnë se Profeti u prek nga magjia, sipas Kuranit, janë keqbërës. A nuk mendojnë ata muslimanë që i besojnë rrëfime të tilla, se nëse Profeti do të kishte rënë në atë gjendje, ku do të përfundonte *umeti*?! Ai do të fundosej krejt! Ne besojmë se çdo hadith që bie ndesh me Kuranin, edhe sikur ai të gjendet në Buhari, është i papranueshëm. Lexoni edhe 6:165; 45:7.

## Surja 114 – En-Nas

Surja En-Nas është medinase dhe, bashkë me *bismil-lahin*, ka shtatë ajete.

Kjo sure ndër të tjera shpalos përpjekjet e përbashkëta të atyre hebrenjve e të krishterëve, të cilët do të pretendojnë të quhen Zoti i njerëzve, pra do të sundojnë ekonominë e tyre; po kështu do të pretendojnë të quhen sundimtarët e njerëzve, pra do ta pushtojnë edhe politikëbërjen e tyre; dhe më pas do të shpallin veten si zota të njerëzve, pra do t'u japin vetëm atyre që i "adhurojnë", dhe do t'i ndëshkojnë e poshtërojnë ata që nuk i "adhurojnë". Arma e tyre e përbashkët do të jetë çytja e dyshimeve në zemrat e njerëzve, duke vepruar si *hannas*, pra si ai që çyt një mendim të keq e më pas fshihet. Kështu do të bëhet edhe gjendja e vendeve të fuqishme, si kapitaliste ashtu edhe komuniste. Ai që dëshiron të shpëtojë prej tyre, ka nevojë t'i kërkojë mbrojtjen e Zotit të vërtetë të njerëzve, të Sunduesit të vërtetë të njerëzve dhe të Adhureshmit të vërtetë të njerëzve.



1. Me emrin e Allahut, të Gjithë-mëshirshmit, Mëshirëbërësit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ۝

2. Thuaj: Kërkoj mbrojtjen e Zotit të njerëzve;

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ ۝

3. të Sunduesit të njerëzve;

مَلِكِ النَّاسِ ۝

4. të Adhuruarit të njerëzve,

إِلَهِ النَّاسِ ۝

5. nga e keqja e cytjes së djallit që fshihet pas cytjes,

مِنْ شَرِّ الْوَسْوَاسِ الْخَفِيِّ ۝

6. që cyt zemrat e njerëzve;

الَّذِي يُوسْوِسُ فِي صُدُورِ النَّاسِ ۝

7. qoftë (cytësi) prej xhindëve, ose prej njerëzve.<sup>1</sup>

يَخْرُجُ مِنَ الْجَنَّةِ وَالنَّاسِ ۝

1. Kjo sure na mëson t'i kërkojmë mbrojtjen Atij Zoti, që është Krijuesi dhe Kujdestari i njerëzve (arab. *rab*), që është Sunduesi i njerëzve dhe që është i Adhureshmi i njerëzve. Pra, t'i kërkojmë mbrojtjen Këtij Zoti, nga cytjet e djallit, i cili, qoftë vetë, qoftë duke qenë brenda njeriut, cyt në zemrat e njerëzve dhe që i largon ata nga besimi. Kështu, kjo sure tregon se do të vinte një kohë kur njerëzit nuk do të shikonin dot kollaj as dhembshurinë e sinqertë, as drejtësinë e vërtetë e as besimin e vërtetë, sepse njerëzit në masë do të besonin te krijuesit dhe kujdestarët e rremë, te sundimtarët e rremë dhe tek të adhureshmit e rremë. Kjo do të ishte pikërisht koha e Dexhallit. Surja En-Nas na tregon se, këto tri vlera, pra *rabi*, sundimi dhe e drejta për t'u adhuruar, në të vërtetë janë të Zotit dhe Atij duhet t'i kërkojmë mbrojtjen, që të ruhem nga sulmet e djallit.

## Lutje kur mbaron leximin e Kuranit të Shenjtë

اللَّهُمَّ ارْحَمْنِي بِالْقُرْآنِ الْعَظِيمِ وَاجْعَلْهُ لِي إِمَامًا وَنُورًا وَهُدًى وَرَحْمَةً  
اللَّهُمَّ ذَكِّرْنِي مِنْهُ مَا نَسَيْتُ وَعَلِّمْنِي مِنْهُ مَا جَهِلْتُ وَارْزُقْنِي تِلَاوَتَهُ  
إِنَاءً لَيْلٍ وَإِنَاءً نَهَارٍ وَاجْعَلْهُ لِي حُجَّةً يَا رَبَّ الْعَالَمِينَ - آمِينَ

O Allah! Më mëshiro në saje të Kuranit të Madhërishëm. Bëje atë për mua drejtues, dritë, udhërrëfyes dhe mëshirë. O Allah! Më kujto atë që kam harruar prej tij dhe më mëso atë që nuk e kam kuptuar prej tij. Më mundëso leximin e tij gjatë orëve të natës dhe gjatë orëve të ditës! Bëje atë argument për mua, o Zoti i botëve! Amin!

## Indeksi i disa prej temave të Kuranit të Shenjtë

- Në këtë Kuran dhe në të gjithë literaturën e Xhematit Musliman Ahmedia, ajeti “*bismillah* ...” llogaritet si ajeti i parë, jo vetëm i sures El-Fatiha, por i çdo sureje të Kuranit të Shenjtë. Për këtë arsye, lexuesi të ketë parasysh se numrat e ajeteve të sureve të Kuranit, në këtë botim, mund të jenë një më shumë sesa numrat e përmendur të ajeteve në kopje të tjera të Kuranit të Shenjtë.
- Në referencat që janë dhënë në këtë indeks, janë të nënkuptuara edhe shënimet përkatëse. Andaj, përveç ajetit të dhënë, shikoni edhe shënimin, nëse ai ajet ka ndonjë.
- Numri i faqes vlen për çështje të ndryshme të shpjguara në parathëniet e sureve.

<b>Abdesi</b>	4:44; 5:7
tejemumi	5:7
<b>Ademi</b> <sup>as</sup> : krijimi i tij	3:60; 7:13; 15:29; 17:62; 38:72
Allahu e krijoi me Duart e Tij	38:76
Allahu e zgjodhi atë	3:34; 17:71
kalif në tokë	2:31
Profeti Adem nuk është njeriu i parë në Tokë	2:32, 36; 7:12; 4:2
xheneti i tij, pema e ndaluar, lakuriqësia e tij, gjethet e xhenetit, etj. ç’janë?	2:36; 7:23; 20:122
ç’është pema e ndaluar?	2:36
Iblisi mohoi t’i bënte sexhde	7:12; 2:35; 15:31-32; 17:62; 18:51; 20:117; 38:74-75
nënshtrimi i engjëjve ndaj tij	2:35; 7:12; 15:30; 17:62; 18:51; 20:117; 38:73-74
katër parime themelore të Sheriatit të tij	20:119-120
porosia për të mos iu afruar pemës së ndaluar	2:36; 7:20
porosia për të ndjekur udhëzimin dy djemtë e tij dhe ngjarja e tyre	20:124; 2:39;
u mashtrua prej djallit	5:28-33
harroi dhe nuk e shkeli premtimin në mënyrë të vullnetshme	2:37; 7:21-23; 20:118, 121-22
dalje nga vendi ku filloi armiqësia	20:116
Allahu ia pranoi pendesën	7:25; 2:36-39; 20:124;
<b>Adët</b> : historia e tyre	2:38; 20:123
popull i zhvilluar dhe i pasur	7:66-73; 11:51-61; 26:124-40; 51:42-43
	26:129-131; 89:7-9; 41:16

» <b>Adët:</b> Zoti i bëri mëkëmbës dhe i begatoi	7:70
Hudi <sup>as</sup> u dërgua te ta	7:66; 11:51; 46:22
iu porositi të kërkonin falje e të luteshin	11:53
i quajti gënjeshtarë Profetët dhe i refuzuan	22:43; 38:13; 7:71; 11:54, 60; 14:10; 26:124; 41:15; 46:22-23; 50:14-15
u shkatërruan për shkak të mendjemadhësisë dhe se i mohuan shenjat	41:14-17
u shkatërruan me një erë të fortë	69:7-9; 41:17; 46:25-26; 51:42-43; 54:20
besimtarët adë shpëtuan	7:73; 11:59
gërmadhat flasin për shkatërrimin e tyre	29:39
u shkatërruan për shkak se e refuzuan të vërtetën	54:19; 7:73; 9:70; 11:60-61; 25:39; 26:140; 40:31-32; 50:14-15; 53:51
<b>Adhurimi:</b> ( <i>ibadet</i> ), kuptimi leksikor dhe spiritual	1:5; Shih edhe: <b>Spiritualizmi</b>
kuptimi i fjalës “rob” ose “robërit e Allahut”	1:5
adhurimi	2:22; 7:32; 22:68 Shih edhe: <b>Namazi</b>
<b>Afati:</b> afati i caktuar	2:232; 2:235; 7:136; 65:3; 11:105; 3:146; 6:3, 129; 7:35; 10:50; 11:4; 13:3, 39; 14:11, 15:6; 16:62; 17:100; 20:130; 22:6, 34; 29:54; 30:9; 31:30; 35:14, 46; 39:43; 40:68; 42:15; 46:4
<b>Afrimi me Allahun</b>	5:36; 13:22; 17:58
<b>Agimi</b>	2:188; 6:97; 54:35; 74:35; 81:19; 89:2; 97:6; 100:4; 24:59
përkujtoni Allahun gjatë agimit	17:79; 3:18, 42; 51:19; 113:2
<b>Agjërimi:</b> urdhri i agjëtimeve të Ramazanit	2:184-188
udhëtari dhe i sëmuri nuk duhet të agjërojnë	2:185-186
marrëdhëniet gjatë Ramazanit	2:188
qëllimi i agjërit	2:184
deri kur mund të hash syfyri?	2:188
sadakaja e mosagjërit ( <i>fidjetus-sijam</i> )	2:185
agjërimi për <i>haxhin temet'u</i> ose për <i>haxhin kiran</i>	2:197
3 ditë agjërimi nëse shkel premtimin	5:90
agjërimi dy muaj rresht si shlyerje për vrasje pa dashje	4:93

» <b>Agjërimi:</b> agjërimi dy muaj rresht si shlyerje për tentimin për t'u ndarë nga gruaja duke i thënë "nënë" (zakoni arab, <i>dhihar</i> )	58:4-5
agjërimi i atij që rruan kokën gjatë <i>ihramit</i>	2:197
agjërimi si shlyerje nëse bën gjueti gjatë <i>ihramit</i>	5:96
<b>Ahireti:</b>	53:26; 92:14
argumente për të	29:65; 2:29; 15:86; 17:50-53, 99-100; 19:67-68; 22:6; 23:116; 30:9; 79:28
besimtarët besojnë në të	2:5; 6:93; 16:23, 61; 27:4; 31:5
besimtarët do të shpërblehen në të	2:26; 3:146, 149; 5:86; 10:5; 12:58; 33:30
ata që punojnë për të, shpërblehen	17:20; 3:146; 42:21
do të ndodhë patjetër	16:39-40; 11:8; 17:50-53; 23:17; 39:32; 102:8;
krahasimi i tij me jetën e kësaj bote	3:15; 3:186, 198-199; 4:78; 6:33; 7:170; 8:68; 9:38; 10:71; 12:58, 110; 13:27; 14:4; 16:31, 42, 108, 118; 17:22; 28:61; 29:65; 40:40; 47:37; 57:21; 75:21-22
përshkrimi i shpërblimit në të	36:56-59; 15:46-49; 44:52-58; 50:36; 52:18-29; 55:47-77; 56:13-38; 77:42-45; 78:32-37; 83:23-29
është i përhershëm	40:40; 44:57; 87:18
jeta e vërtetë është pikërisht ahireti	26:65; 4:78
atje do të gjykohej çdo vepër	3:31; 18:50; 20:16; 39:71; 99:8-9
përhëndetja me <i>selam</i> në të	10:11; 13:25; 14:24; 15:47; 33:45; 36:59; 39:74; 50:35
dija e njeriut nuk e percepton dot plotësisht	27:67; 20:111
gjykimi i vërtetë do të bëhet atje	39:76
asnjë shpirt nuk mund të shpërblejë askënd	2:49; 2:124; 31:34; 82:20
askujt nuk do t'i bëhet padrejtësi	3:26; 3:118; 14:52; 40:18; 45:23; 74:39
njeriu do t'i shohë të gjitha veprat e tij	17:14; 39:70; 45:29; 83:7-10; 83:19-21; 102:9
lutje për të	2:202; 7:157
ndëshkimi në të	16:28; 2:86-87; 5:34; 13:35; 17:11; 22:10; 27:6; 33:58; 34:9; 39:27; 41:17; 46:36; 57:21; 68:34; 79:47;
ndëshkimi për mohuesit në të	3:57; 2:218; 17:11; 23:75; 27:5-6; 30:17; 34:9; 35:8
do të dëshmojnë gjymtyrët dhe organet e njeriut	36:66; 41:21-23
ringjallja atje	39:68-76

» <b>Ahireti:</b> mirëbërësit nuk do t'i humbin veprat atje	7:171; 9:120; 12:57; 18:31; 27:6; 39:35-36
ai që mbeti i verbër shpirtërisht këtu, po i verbër do të jetë atje	17:73; 18:102; 20:125-127
ata që e mohojnë, nuk kanë dije të saktë	45:25; 6:30-32; 10:46; 16:23; 19:67; 23:38; 27:5-6; 30:8; 39:46; 44:35-37; 74:54
ndër fajtorët, do të ketë shumë sykaltër	20:103
pafajësia e saj	24:12-20
<b>Alarmues:</b> paralajmërues i ndëshkimit, një nga cilësitë e Profetëve	35:24-25; 2:120, 214; 4:166; 5:20; 7:185, 189; 11:3, 13, 26; 15:90; 17:106; 22:50; 25:2, 8, 52, 57; 26:115-116; 27:93; 28:47; 29:51; 32:4; 33:46; 34:29, 35, 47; 35:38, 43; 38:71; 41:5; 46:10; 48:9; 51:51; 53:57; 67:9-10, 27; 71:3
<b>Alkooli:</b> i ndaluar	2:220; 4:44; 5:91-92
vera e xhenetit që nuk të deh	47:16; 56:18-20
<b>Allahu:</b> kuptimi i emrit Allah	1:1
njeshmëria absolute e Tij	112:1-5
Ai jep jetë dhe vdekje	15:24; 2:29; 13:17; 22:67; 30:41; 40:12, 69; 45:27; 50:44; 53:45
vetëm Ai ka dijen e të shkuarës dhe të së tashmes	2:256; 20:111; 21:29
vetëm Ai e di të padukshmen	27:66; 3:30, 180; 6:60, 74; 9:78, 94; 10:21; 11:50, 124; 12:103; 13:10; 16:78; 34:4; 35:39; 72:27; 81:25
u përgjigjet lutjeve	2:187; 3:39, 196; 6:42; 8:10; 11:62; 12:35; 14:40; 21:85, 89, 91; 27:63; 34:51; 40:61; 50:17
“asgjë nuk është si Ai”	42:12
“nuk Na preku lodhja aspak”	50:39
një akuzë e ateistëve për cilësinë e tij i <i>Plotfuqishëm</i> , dhe përgjigja	2:21
edhe ateistët Atë e thërrasin për ndihmë	7:173; 7:6
çdokush e çdo gjë i bindet Atij, me hir e pahir; që të gjithë Atij i janë nënshtruar	13:16; 64:2; 30:27
të caktosh ortakë me të	shih: <b>Shirku</b>
atributet, Emrat e Allahut, <i>Esmā'ul Husna</i>	shih: <b>Emrat e Allahut</b> 1:4; 2:256; 7:181; 17:111; 20:9; 37:160-161; 59:23-25; 112:2-5
tregtia me Të	9:111; 4:75; 2:175; 2:17, 42; 3:78, 188; 5:45; 9:9; 16:96
thotë “bëhu” dhe ajo bëhet “ <i>kun fe jekun</i> ”	19:36; 2:118; 3:48, 60; 6:74; 16:41; 36:83; 40:69



» <b>Allahu:</b> nuk e thyen premtimin	30:7; 3:195; 4:123; 10:5; 14:48; 31:10;39:21; 40:56, 78
nuk ngarkon asnjë shpirt përtej fuqisë që ka	2:287; 2:234; 6:153; 7:43; 23:63; 65:8
bën thirrje për vendosjen e paqes	10:26; 6:128
lutjuni Atij me frikë dhe shpresë	7:57; 21:91; 32:17
i zgjedh të Dërguarit	2:131; 2:106; 3:34, 75; 7:145; 12:7; 19:52, 59; 20:14, 123; 22:76; 27:60; 38:47; 42:14; 68:51; 72:28
është më afër se damari i qafës	50:17; 2:187; 11:62; 34:51; 56:86; 57:5
nderi i gjithi i takon Atij	10:66; 35:11
nëse të prek me ndonjë vështirësi, s'ka kush që mund ta largojë atë, përveç Atij. Dhe nëse Ai do ndonjë të mirë për ty, nuk ka largues të bekimit të Tij	10:108; 6:18; 39:39
krijoi çdo gjë nga uji	2:46; 21:31; 25:55; 32:9; 77:21
krijoi qiejt dhe tokën me vërtetësi	29:45; 6:74; 14:20; 15:86; 16:4; 39:6; 64:4
krijoi qiejt dhe tokën	41:10-13; 2:165; 3:191; 6:2; 7:55; 10:4, 7; 11:8; 14:33; 25:3, 60; 29:62; 30:23; 31:11; 32:5; 35:4; 38:28; 39:63; 40:63; 43:10; 44:39; 46:4; 50:7-8, 39; 57:5; 65:13; 67:4; 71:16-18
krijoi njeriun	2:22, 30; 4:2; 6:103; 7:190; 13:17; 15:29, 86; 16:73; 20:56; 21:17, 34; 23:13-15, 18; 24:46; 27:65; 30:21-22; 35:4; 36:37; 38:72; 39:7; 41:10; 43:13; 46:4;50:17; 53:46; 55:4, 15- 16;59:25; 67:3; 71:15; 87:3; 92:4;96:3
të vdekurit nuk i kthen kurrë në këtë botë	21:96; 23:100-101; 36:32; 39:43
dëshiron lehtësi për njeriun	39:54; 7:157; 12:88; 15:57
shpresa në mëshirën e Tij	36:54; 7:157; 12:88; 15:57
nuk imponon në besim	10:100; 2:257; 5:49; 6:150; 11:119;13:32; 16:10, 107; 18:30; 42:9
nuk i do ata që	31:19; 2:191, 206, 277; 3:33; 4:37, 108, 149; 5:65; 7:32; 8:59; 16:24; 22:39; 28:77-78; 42:41
nuk i do keqbërësit	28:78; 2:12-13, 28, 61, 252; 5:33-34, 65; 7:57, 75, 87, 104, 143; 8:74; 10:82; 11:86; 13:26; 17:5; 18:95; 26:153, 184; 28:5, 84; 38:29; 89:13
nuk e zë as dremitja e as gjumi <i>Ajetul-Kursij</i>	2:256
sundimi i Tij shtrihet mbi gjithçka	23:89; 3:27; 11:57; 13:16; 25:3; 36:84; 67:2
rrethon mohuesit	2:20; 8:48; 85:20-21
strategu më i mirë	8:31, 3:55

» <b>Allahu:</b> urdhëron të mirën, ndalon nga e keqja	9:112; 2:45, 178; 3:105, 111, 115; 5:3; 9:71; 22:42; 31:18; 58:10
urdhëron namazin, zekatin dhe bamirësinë	5:13; 2:44, 84, 111, 178, 278; 4:163; 5:56; 9:5, 11, 18, 71; 19:32, 56; 21:74; 22:42, 79; 24:38, 57; 27:4; 31:5; 33:34; 58:14; 73:21; 98:6
nderon kë të dojë ( <i>refa</i> )	3:27; 2:254; 3:56; 4:159; 6:166; 7:177; 19:58; 24:37; 40:16; 56:4; 58:12
ekzistenca e Tij	2:29; 2:165, 187; 6:74; 7:173; 10:7, 32; 13:3-5; 22:19; 25:3-4; 27:61-67; 30:21-28; 31:11-12; 45:3-7; 87:2-6
sytë nuk e arrijnë Atë, Ai i arrin sytë	6:104
bekimet e Tij	31:32; 2:23; 6:100, 142; 7:55; 13:3-5, 18; 14:33-35; 15:20-23; 16:6-17, 67-70, 72-73, 79, 81-82; 17:21; 20:54-55; 21:32-34; 22:64, 66; 23:20-23; 27:62-64; 31:21; 35:13, 28; 36:35; 40:62, 65, 80-81; 43:11-14; 45:13-14; 51:49; 55:17; 56:65, 69, 72; 67:24; 71:17-21; 77:28; 78:7-17
bekimet e Tij janë të pafundme	16:19; 14:35
bekon mirënjohësit	14:8; 4:148; 39:8
“ndiq natyrën e Allahut”	30:31
fal kë të dojë	48:15; 2:285; 3:130; 4:117; 5:19, 41
Mik i besimtarëve	2:258; 3:69; 4:126; 5:56; 6:128; 10:63-64; 45:20
ringjall të vdekurit	6:37
mirëbërës ndaj njerëzve	27:74; 2:244, 252; 4:55; 10:61; 40:62
mbrojtës i Kuranit	15:10; 5:49; 15:19; 37:11
udhëzues i rrugës së drejtë	16:10; 2:143, 214, 273; 3:74; 6:40, 89, 127, 154; 7:179; 9:115; 10:26, 36; 13:28; 14:5; 16:94; 17:98; 18:18; 22:17; 24:36, 47; 28:57; 29:70; 33:5; 34:7; 35:9; 39:24, 38; 42:14; 74:32
ka fuqinë të bëjë gjithçka që dëshiron	2:21; 2:110, 149, 260; 3:30, 166, 190; 5:18, 20, 41, 121; 8:42; 9:39; 11:5; 16:78; 24:46; 29:21; 30:51; 35:2; 41:40; 42:10; 46:34; 48:22; 57:3; 59:7; 64:2; 67:2
Ai dhe të Dërguarit e Tij do të triumfojnë	58:22; 5:57; 37:172-173; 58:23
Ai nuk është i lindur dhe as nuk ka lindur kënd	112:2-5
ndihmon besimtarët	40:52; 2:215; 10:104; 30:48
nëse e doni Atë, ndiqni Profetin <sup>savs</sup>	3:32; 4:31; 39:54
është drita e qiejve dhe e tokës	24:36; 9:32; 39:70; 61:9

» <b>Allahu:</b> nuk bën padrejtësi	3:183; 8:52; 17:72; 22:11; 24:51; 26:210; 41:47; 50:30
dija e Tij përfshin gjithçka	2:256; 4:127; 6:4, 60; 10:62; 20:8, 111; 21:29; 27:75; 28:70; 34:3-4; 35:39; 50:17; 58:8; 67:14
di atë që fshihni dhe shfaqni	64:5; 2:78; 3:120; 5:100; 6:4; 9:78; 11:6; 16:20, 24; 20:8; 21:111; 27:26, 75; 28:70; 33:55; 35:39; 36:77; 67:14
i do ata që ...	3:135; 2:196, 223; 3:77, 147, 149, 160; 5:43; 9:4, 7, 108; 49:10; 61:5
dashuria e Allahut	3:33; 2:166
jep shpërblime të shumëfishta për ata që shpenzojnë në rrugën e Tij	2:262; 2:246, 266; 30:40; 57:12, 19; 64:18; 73:21
takimi me Të	25:22; 6:32; 7:148; 10:8, 12, 46; 11:30; 18:106, 111; 29:6, 24; 30:9, 17; 32:11; 84:7;
mëshiron ata që pendohen dhe besojnë	7:154; 2:161; 3:90; 4:18, 147; 5:40; 6:55; 7:150; 16:120; 20:83; 24:6; 25:72; 28:68; 40:8
mëshira e Tij e tejkalon zemërimin e Tij	6:161; 6:13, 55; 28:85
kurrë nuk e shkatërron një vendbanim pa një paralajmërues	26:209; 6:132; 7:95, 97, 102; 11:118; 17:16; 20:135; 28:60; 29:35; 35:38
nuk gjen ndryshim në praktikën e Tij	35:44; 17:78; 33:39, 63; 48:24
nuk ka të adhurueshëm tjetër përveç Tij	40:4; 37:36; 2:164, 256; 3:3, 19, 63, 65; 4:88; 5:74; 6:20; 9:31; 16:3, 23, 52; 21:26; 22:35; 23:117; 28:71; 37:5; 40: 63
askush nuk mund t'i ndryshojë fjalët e Tij	6:35; 6:116; 10:65; 18:28; 50:30
askush nuk i ngjan Atij	42:12; 112:5
nuk duhet adhuruar tjetër përveç Tij	1:5; 2:23, 84; 4:37; 7:60, 74, 141; 12:41; 16:37; 17:24; 41:15
nuk u lodh nga krijimi i qiejve dhe i tokës	2:256; 46:34; 50:16, 39
është i pranishëm kudo	2:116; 2:143; 26:29; 37:6; 55:18; 73:10
ka premtuar falje dhe shpërblim	48:30; 2:269; 3:137; 8:5; 22:51; 24:27; 33:36; 34:5; 35:8; 36:12; 47:16; 49:4; 67:13
furnizon dhe ushqen	11:7; 2:23, 61; 6:15, 152; 8:27; 10:32, 60, 94; 15:21; 16:73, 115; 17:31-32, 71; 20:133; 27:65; 29:61; 35:4; 40:65; 42:20
ndëshkon ata që i bëjnë keq vetvetes	11:102; 3:118; 9:70; 10:45; 16:34, 119; 18:50; 29:41; 30:10
ndëshkon keqbërësit dhe mohuesit	2:16; 3:57; 4:174; 8:53; 9:26, 74, 79; 11:9; 18:88; 21:42; 35:27; 46:27; 48:7, 17; 68:45; 69:26-33; 79:26; 88:25; 89:7-14
pastron kë të dojë	24:22; 2:175; 3:43
na drejtohet me “Ne” dhe “Unë”	14:15

» <b>Allahu:</b> përkujtimi i Tij	13:29; 2:153, 204; 3:192; 4:104; 7:206; 8:46; 10:13; 24:38; 26:228; 29:46; 33:42; 39:10; 43:37; 57:17; 62:10-11; 63:10; 73:9
dërgon shpallje përmes Profetëve të zgjedhur	4:164; 2:137; 3:54, 85; 4:62; 4:163; 5:16, 45, 105; 6:20, 84-91; 7:204; 10:48; 13:2; 14:2; 16:37; 35:25; 42:52-53
shenjat e Tij	2:165; 2: 212; 3:50; 4:141; 5:3; 6:5, 47, 127; 7:41, 134, 204; 10:6-8, 16, 18, 21-22, 25; 13:28; 16:66; 17:13, 102; 20:43, 48, 54-57, 73; 27:13; 28:37; 30:20-26; 31:32; 36:34-43, 47; 41:38-41; 42:30, 33-36; 45:7; 51:38
dërgon qetësi	48:27; 9:26
kërkim mbrojtje tek Ai	23:98-99; 2:68; 7:201; 9:118; 12:24; 16:99; 19:19; 40:28, 57; 41:37; 44:21; 72:23; 113:2; 114:2
vulos zemrat e atyre që ...	2:8; 4:156; 9:87, 93; 16:109; 30:60; 40:36; 47:17; 63:4
të shpenzosh në rrugën e Tij	2:268; 2:4, 196, 216, 220, 246, 255, 263, 265, 273, 275; 3:93; 8:4, 61; 9:20, 34, 41, 99, 111; 13:23; 14:32; 16:76; 22:36; 24:38-39; 28:55; 32:17; 35:30; 42:39; 47:39; 57:8, 11; 61:12; 63:11; 64:17-18; 65:8; 73:21
i bën miq ata që ...	3:29; 3:119; 4:140, 145; 9:16, 23
Arshi i Tij	Shih: <b>Arshi</b>
të Atij jemi, te Ai do të kthehemi	2:157; 7:126; 21:36; 26:51; 96:9
të sprovon me pasuri dhe fëmijë	8:29; 24:38; 63:10; 64:16; 102:2
ai që trillon gënjeshtër në emër të Tij	10:18; 2:141; 3:76, 79, 95; 4:51; 5:104; 6:22, 94, 145; 7:38; 10:70; 11:19, 36; 18:16; 20:62; 29:69; 34:9; 39:33; 40:29; 42:25; 61:8; 69:45-47; 72:5-6
fjalët e Tij nuk mbarojnë	18:110; 31:28
për atë që pretendon të jetë Zoti	21:30
<b>Amanetet:</b> diçka që të besohet	4:59; 2:284; 3:76; 5:68; 8:28; 23:9; 33:73; 51:20; 70:33;
<b>Antropomorfizëm:</b> ( <i>texhsim</i> )	3:104; 2:256; 3:74; 5:65; 6:104; 7:55, 144; 43:82; 48:11; 52:49; 54:15; 57:30
<b>Apostazia:</b> nuk ka dhunë në fe	2:257; 2:109; 4:168; 7:89; 10:20, 100; 11:119; 16:107; 18:30; 24:48-9; 42:9; 63:4
ndëshkimi i apostatëve është në dorë të Zotit, jo të njeriut	4:138; 2:162, 218; 3:87-92, 107, 145; 4:116; 5:6, 55; 9:74; 16:107; 47:26, 35; 63:4
në fenë Islame nuk ka dënim me vdekje për apostatin	3:91; 4:138; 2:218; 5:55
dënimi me vdekje për apostatin është praktikë e kundërshtarëve të Profetëve	f. 398

» <b>Apostazia:</b> apostatët nuk e dëmtojnë dot aspak Allahun dhe Islamit	3:145; 3:73-74, 177-178; 5:55; 47:39
<b>Arabët:</b>	7:158; 9:97, 99; 49:15-16
përpara kohës së Profetit	3:104; 106:3
beduinët arabë	49:15; 9:90, 97-99, 101, 120; 33:21; 48:12, 17
zakonet e tyre	5:104; 4:23; 6:137-141; 9:37; 16:59-60; 33:5; 43:18
mohuan mëshirën e Zotit	21:37
idhujt e tyre	71:24; 53:20-21
<b>Arabisht:</b> gjuha arabe	12:3; 13:38; 16:104; 20:114; 26:196; 39:29; 41:4, 45; 42:8; 43:4; 46:13; 50:31
nëna e gjuhëve	6:93
<b>Arafati:</b>	2:199-200
<b>Arka e Nuhut:</b> Shih edhe: Nuhu <sup>as</sup>	11:38-45; 7:65; 10:74; 17:4; 19:59; 23:28-30; 26:120; 29:16; 54:14-15
<b>Arka e qetësisë:</b> arka në të cilën ka qetësi prej Zotit	2:249
<b>Armët:</b>	4:103; 2:191-192; 9:41; 22:40; 104:2-10
<b>Armiqësia:</b>	2:37; 5:65, 92; 7:25; 12:101; 20:124; 60:5
mes hebrenjve e të krishterëve	5:15
e djallit	2:169; 2:209; 6:143; 7:23; 12:6; 17:54; 20:118; 28:16; 35:7; 36:61; 43:63
e mohuesve	2:98-99; 3:29, 119-121; 4:102; 7:130; 8:61-62; 9:12-14; 41:20, 29; 60:2; 60:8; 63:5
ndaj Profetëve	6:113; 9:114; 18:51; 20:118; 25:32
<b>Arshi:</b> Froni i Allahut; Si është dhe çfarë do të thotë?	7:55; 11:8; 57:5; 69:18; 10:4; 2:256; 9:129; 13:3; 17:43; 20:6; 21:23; 23:87, 117; 25:60; 27:27; 32:5; 39:76; 40:16; 43:83; 53:7; 81:21; 85:16
<b>Atom:</b> (grimca)	104:2-10; 4:41; 10:62; 34:4, 23; 36:30, 54; 70:10; 99:8-9
<b>Babilonia:</b>	2:103; 17:6-7
<b>Bal'em Ba'ur:</b> ai që anoi nga toka	7:176-177
<b>Bamirësia:</b> <i>sadaka</i> dhe të shpenzuarit në rrugë të Allahut; mjet për pastrimin shpirtëror dhe për pendesën	9:103-4; 57:19
është e drejta e njerëzve në nevojë	30:39
haptas e fshehtas, por fshehtas është më e mirë	2:272; 2:275
porosi edhe për gratë	33:34
vjelja dhe shpërndarja e këtyre parave	2:274; 9:60, 103; 59:8;

» <b>Bamirësia:</b> të shpenzuarit në rrugë të Allahut nga besimtarët	2:255; 2:4, 178, 196, 262, 263, 268, 274; 3:18, 93; 8:61; 9:60, 104; 14:32; 47:39; 57:8, 11; 63:11; 64:17; 70:25; 73:21
të shpenzuarit nga mohuesit	3:117-118; 4:40; 9:34
të shpenzuarit nga hipokritët	3:181-183
shpërblimet e të shpenzuarit në rrugë të Allahut	2:246; 2:262-263, 273, 275; 5:13; 8:61; 9:121; 57:8, 12, 19; 64:18
metodat	2:216; 2:264-265, 272-273; 4:39; 17:27-28; 25:68; 93:11
një fjalë e mirë dhe një falje është më e mirë sesa një lëmoshë që përcillet me lëndim	2:264
urdhri për Isain për zekat	19:32
lëmoshë përpara të këshilluarit me Profetin	58:13
jepua njerëzve në nevojë	2:178; 9:60; 17:27; 21:74; 30:39; 76:9; 98:6;
jepua me fjalë të mira	2:264-5
do t'ju rikthehet e gjitha, madje e shumëfishuar	2:273; 2:246, 266, 277; 30:40; 57:12, 19; 64:18; 73:21
djalli ju frikëson nga të shpenzuarit në rrugën e Zotit	2:269
dhuro edhe fshehtas, edhe haptas	2:275; 2:272; 13:23; 14:32; 16:76; 35:30
besimtarët që shpenzojnë në rrugë të Zotit janë të suksesshëm	23:5; 2:44, 84, 111, 178; 4:163; 5:56; 9:71
të shpenzuarit në rrugë të Allahut	2:268; 2:4, 196, 216, 220, 246, 255, 263, 265, 273, 275; 3:93; 8:4, 61; 9:20, 34, 41, 99, 111; 13:23; 14:32; 16:76; 22:36; 24:38-39; 28:55; 32:17; 35:30; 42:39; 47:39; 57:8, 11; 61:12; 63:11; 64:17-18; 65:8; 73:21
<b>Banorët e shpellës:</b>	18:10-27
<b>Barazia:</b>	4:2; 33:36; 49:14; 2:179; 3:116, 196; 4:4, 8, 13, 33, 96, 125; 16:72, 98; 24:62 Shih edhe: <b>Drejtësia</b>
<b>Bashkëshortët:</b> krijimi në çift është shenjë e ekzistencës së Zotit; 4 tipare të tyre	30:22
lutje për bashkëshortët	25:75
lutja e Hazret Musait <sup>as</sup>	28:25
çfarë sjellje duhet të kenë me njëri-tjetrin	2:188; 4:20; 2:234; 2:241
janë petk për njëri-tjetrin	2:188
në xhenet	2:26; 4:125; 36:57; 43:71

» <b>Bashkëshortët:</b> krijuar në çift	36:37; 11:41; 13:4; 20:54; 23:28; 37:23; 42:12; 43:13; 51:50; 53:46; 78:9
	Shih edhe: <b>Martesa, Divorci, Gratë, Poligamia</b>
<b>Bejati:</b>	48:11; 48:19; 60:13; Shih edhe: <b>Besa</b>
<b>Bekimet:</b>	1:7; 2:41, 48, 123, 151, 212, 232; 3:104, 172, 175; 4:70; 5:4, 7-8, 12, 21, 111; 8:54; 12:7; 14:7, 29, 35; 16:19, 54, 72-73, 84, 122; 19:59; 26:23; 27:20; 28:18; 31:32; 33:10; 35:4; 37:58; 39:9, 50; 46:16; 48:3; 49:9; 52:30; 54:36; 68:3, 50; 93:12
<b>Benjamini:</b> vëllai i Jusufit	12:59-90
vëllezërit e tjerë	2:137
<b>Berzahu:</b> bota e ndërmjetme	23:101
rreth kohëzgjatjes midis vdekjes dhe ringjalljes	f. 561-562
<b>Besa:</b> marrëveshjet, traktatet	16:92-3; 2:28, 41, 178; 3:77-78; 5:2; 6:153; 8:57; 9:4, 111; 13:21; 16:96; 17:35; 23:9; 48:11; 70:33; 8:59
<b>Besëlidhja:</b> premtimi	28:77; 28:80, 82-83; 29:40-41; 40:25;
me Ibrahimin <sup>as</sup>	2:125; 2:126
me Allahun	3:78; 2:28; 6:135, 153; 13:21, 26; 16:92, 96; 33:24; 57:9; 68:40;
me besimtarët	48:11; 2:177, 238, 257; 5:2, 8; 4:22; 8:57-59, 73; 9:8, 12-13, 75, 111; 17:35; 23:9; 70:33;
me hebrenjtë	5:14; 2:41, 64, 84-85, 94, 101; 3:184; 4:155, 156; 5:13, 71; 7:135; 20:81; 33:16; 43:50;
me Profetët	3:82; 33:8
premtime në martesë	2:236; 4:22
<b>Besimi:</b> i njeriut të mirë	2:178
ata që nuk kanë besim	2:7-8; 2:14; 4:39, 138, 151-152; 6:151, 159; 7:28, 102; 8:56; 10:91-93, 97-98, 102; 13:2; 36:8; 40:60, 86; 41:45
besimi në Allahun, në engjëjt, në Librat, në të Dërguarit e Tij, në të padukshmen, në botën e përtejme	2:286; 2:7-8
besimi në Ditën e Gjykimit	2:5
mos i impono të tjerët të bëhen besimtarë	10:100
besimi i vërtetë të siguron këto shenja	8:30
nivele të ndryshme të besimit	35:33
<b>Beteja e Bedrit:</b>	3:124; 3:14, 141, 166; 8:6, 8, 13, 16, 18, 42-45, 49; 25:26-27; 54:46, 51

» <b>Beteja e Bedrit:</b> fitorja në të	2:211; 3:14, 124; 8:8-13, 18; 32:30
ndihma përmes engjëjve	8:10
<b>Beteja e Hendekut:</b>	33:10-26; 38:12
Beteja e Hunejnit	9:25; 9:2; 33:22
<b>Beteja e Tebukut:</b>	9:38; 9:41-42, 117
<b>Beteja e Uhudit:</b>	33:22; 3:122-130, 142, 153-156, 160, 167-175; 8:67; 22:67; 59:3; 71:29
<b>Betimet:</b> mbajtja e tyre	16:92-93; 2:226; 3:78; 5:90; 16:95
mos e bëni Allahun si pengesë	2:225
shlyerja e tyre, nëse i thyeni	5:90; 66:3
për të mos patur marrëdhënie me gruan e Allahut	4:66; 15:73, 93; 16:57, 64; 36:3; 37:2-4; 38:2; 43:2-3; 44:2-3; 50:2; 51:2-8, 24; 52:2-7; 53:2; 56:76; 68:2; 69:39, 40; 70:41; 74:33, 35; 75:2-3; 77:2-6; 79:2-6; 81:16-19; 84:17-19; 85:2-4; 86:2, 12-13; 89:2-5; 90:2, 4; 91:2-8; 92:2-4; 93:2-3; 95:2-4; 100:2; 103:2-3
pse betohet Allahu?	37:2; 91:2-16
e mohuesve, hipokritëve, idhujtarëve	58:17; 4:63; 5:54; 6:110; 9:42, 56, 62, 95, 96, 107; 12:74; 16:39; 24:54; 27:50; 30:56; 35:43; 58:19; 63:3; 68:11
e Profetëve	34:4; 21:58; 48:11; 64:8
e Djallit	38:83; 7:22
Kuranore	37:2; 52:2-7; 91:2-8
<b>Bibla:</b> (Teurati dhe Inxhili)	3:4-5; 3:49; 5:47, 67, 69, 111; 7:158; 57:28
shfuqizimi i saj përmes Kuranit	2:107
ndërhyrja e njeriut në të	2:80; 2:76; 3:66, 79; 4:47; 5:42
profecitë e saj për Islam, Profetin	7:158; 61:7; 9:111; 48:30
Allahu e zbriti atë me udhëzim dhe dritë	5:45
Teurati dhe Profeti <sup>savs</sup>	7:158; 2:150; 23:21; 45:17-19; 48:30; 61:7
Teurati dhe Kurani	28:50; 3:4-5; 5:16; 9:111; 61:7
Teurati: lufta në rrugën e Allahut	9:111
Teurati: ligji që i parapriu Kuranit	45:17; 3:49; 5:45-48
Teurati: i përsosur për çdokënd që bënte mirësi	6:155
udhëzim për judenjtë	45:17; 3:4-5, 51, 66, 94; 5:44-45, 67, 111; 6:92, 155; 17:3; 23:50; 28:44; 32:24; 37:118; 40:54-55; 61:7; 62:6
Teurati: shtrembërimi në të	2:80; 2:76; 3:79; 4:47; 5:14, 42
<b>Bidatet:</b> <i>bidate</i> , risi	57:28



<b>Bijtë e Ademit:</b> “O bijtë e Ademit!”	7:27; 7:28; 7:32; 7:36; 7:173; 36:61; 17:71
<b>Bijtë e Izraelit:</b> Zoti i bekoi	2:41; 2:48, 51-59, 61-73, 123; 5:21; 7:161; 10:94; 14:7; 17:105; 26:60; 45:17
emrat e 12 bijëve të Jakubit <sup>as</sup> (Izraelit), sipas Biblës	2:137
Zoti u dha profetëri, shenja, sundim dhe epërsi	7:106; 2:212, 247-253; 3:94; 5:33, 78, 111; 7:135, 138-139; 17:3, 5, 105; 20:95; 21:73-74; 26:60, 198; 29:28; 32:24; 40:54; 44:33; 45:17
Musai <sup>as</sup> i shpëtoi	20:78-79; 7:106; 20:48; 26:53; 28:6-7; 44:24
Eksodi i tyre	20:78-79; 2:51, 244; 7:137; 17:104; 26:53; 44:24
“ngritëm (malin) Tur mbi ju”, kuptimi	2:64
mirëbërësit prej tyre	3:114
Besëlidhja e tyre	2:64; 2:41, 94; 5:13-14
shtëpitë e tyre në Egjipt	10:88
persekutimet ndaj tyre	2:50; 7:142; 14:7; 28:5
iu rikthyen idhujtarisë	2:52; 2:55, 68-71, 94; 7:139; 20:98
shkeljet e tyre	5:78-80; 2:55, 62, 66, 80; 4:47, 161-162; 5:14, 42; 7:164, 167; 16:125; 17:5-8; 20:87
thyen besën	5:14; 2:60, 80, 84-94; 4:154-158; 5:71; 7:136, 147-157, 162-169
mosbindja u sollli 40 vjet vonesë për ta pasur tokën e shenjtë	5:27
dy herë shkaktuan trazira në tokë	17:5
<i>mana</i> dhe <i>selva</i> për ta	2:58; 7:161; 20:81
Jezusi iu dërgua atyre	3:50; 4:158; 5:73, 111; 43:60; 61:7, 15;
pretendime	2:62; 2:56, 247, 250; 5:23; 20:81-82; 61:6
<i>sabati</i>	2:66-67; 4:48, 155; 7:164; 16:125; 62:10-11
“Bëhuni majmunë të poshtër!”	2:66
therja e lopës dhe ringjallja e një të vdekuri; kuptimi	2:74
<b>Bindja:</b> ndaj Allahut dhe të Dërguarit të tij	24:48-55; 3:21, 33, 51, 133; 4:14, 60, 65, 70, 81; 5:93; 8:2, 21, 47; 24:57; 26:108-109, 127, 145, 164, 180; 33:34, 36-37, 72; 43:64; 47:21, 34; 48:18; 58:14; 64:13, 17;
mohuesit, të ligjtë dhe hipokritët nuk e kanë	3:150; 3:101; 6:117, 122; 13:38; 18:29; 25:53; 33:2, 49; 68:9, 11; 76:25; 96:20
ndaj Profetit të Shenjtë <sup>savs</sup>	3:32; 3:21, 54; 4:65; 33:36-37; 49:8; 39:54
bindja ndaj Profetit të sjell dashurinë e Allahut	3:32

» <b>Bindja:</b> bindja ndaj Allahut dhe Profetit Muhammed i mundëson njeriut pozita si: të dëlirë, dëshmor, të vërtetë dhe profet	4:70
do të jenë të suksesshëm ata që i binden Allahut dhe Profetit	24:53
ndaj prindërve, ndaj bashkëshortëve	31:16; 4:35; 29:9
ndaj autoriteteve	4:60
shpërblimi i bindjes	4:70; 3:173
<b>Birësimi:</b>	33:5; 28:10; 33:38
<b>Bismil-lahi:</b> është ajeti i parë i çdo sureje, përveç sures nr. 9; argumente	2:1
përsëritet dy herë në suren nr. 27	27:31
<b>Bizantinët:</b>	30:3-5
<b>Blasfemia:</b>	33:58; 33:49
dënimi i saj nuk është vrasja; profecia për një kohë kur do të shtohet blasfemia ndaj Profetit	3:187
<b>Briri:</b> boria, <i>suri</i>	23:102; 6:74; 18:100; 20:103; 27:88; 36:52; 39:69; 50:21; 69:14; 78:19
<b>Bujqësia:</b> Ibrahim i çoi familjen në një tokë pa bimësi	14:38
Allahu dërgon shi që ajo të zhvillohet	6:100; 2:23; 10:25; 13:18; 14:33; 16:11-12, 66; 18:46; 20:54; 22:64; 25:49-50; 27:61; 32:28; 35:28; 39:22; 50:10; 79:32
ushqimi për zhvillimin intelektual dhe shpirtëror	13:5
të korrat e ahiretit	42:21
zakonet e idhujtarëve që caktonin drithërat për idhujt	6:137
shpjegimi i Jusufit për ëndrrën e mbretit për drithërat	12:48-50
Allahu i rrit të mbjellat	56:64-65
shembull i mendjemadhësisë	10:25
njerëzimi ka punuar tokën që nga lashtësia	30:10
mjet i përkohshëm i jetës së kësaj bote	3:15
<b>Burgosurit (të):</b>	8:68-9; 2:86, 178; 4:25; 5:90; 8:71; 9:60; 33:27; 47:5; 58:4; 76:9; 90:14
<b>Burimi:</b>	88:13; 2:61; 7:161; 15:46; 17:91; 23:51; 26:135, 148; 36:35; 39:22; 44:26, 53; 54:13; 55:51, 67; 77:42; 83:29

<b>Caktimi:</b> caktimi i Allahut (kaderi)	4:79-81; 7:35; 11:102; 23:44; 25:3; 26:81; 53:40; 54:50; 65:4; 74:39
caktimi, <i>takdiri</i>	4:80; 10:109; 17:16; 27:93; 29:7; 30:54; 39:42; 42:31; 45:16; 52:22; 53:39-43; 87:3
triumfon Vullneti i Allahut	24:44; 3:155; 6:59; 9:51; 10:20; 11:57, 111; 12:42; 13:40; 15:5; 16:105; 31:35; 32:6; 33:39; 41:46, 48; 59:4; 64:12
caktimi i përcaktuar	34:31; 3:146; 6:3; 7:35; 10:50; 13:39; 16:62; 20:130; 23:44; 29:54; 42:15; 65:4; 72:26; 77:23
vullneti i lirë	13:28; 3:87; 6:36, 126; 13:12, 32-33; 16:94, 105; 35:46; 71:5; 74:32; 76:4; 90:11
i shkruar në libër	57:23; 6:39; 10:62; 17:59; 20:53; 27:76; 34:4; 35:12; 54:53-54
<b>Çmim i vogël:</b>	16:96; 2:42, 80, 175; 3:78, 188, 200; 5:45; 9:9; 12:21, 89
<b>Dashuria në besim:</b> dashuria e vëllazëria në besim	48:30; 3:104; 5:55; 8:64; 59:10-11; 19:97
<b>Davudi</b> <sup>as</sup> : dy njerëz iu futën në dhomë dhe gjykimi i tij për ta	38:22-25
mirësitë e Zotit mbi të	2:252; 4:164; 6:85; 17:56; 21:79-81; 27:16-17; 34:11-12; 38:18-27, 31
i mallkoi mohuesit prej bijve të Izraelit	5:79
nënshtrimi i maleve për të	21:80; 34:12
<b>Deti/lumi:</b> deti, lumi	55:20-21; 6:60; 18:61, 110; 25:54; 27:62, 64; 31:28; 35:13; 52:7; 81:7; 82:4
pengesë mes deteve	25:54; 35:13
bashkimi i deteve	18:61-62; 55:20-21
u hap për Musain <sup>as</sup>	2:51; 7:137, 139; 10:91; 20:78-79; 26:64; 28:41; 51:41
mundëson jetesën	16:15; 35:13
për lundrim	55:25; 2:165; 10:23; 17:67-68; 22:66; 27:64; 31:32; 35:13; 36:42; 40:81; 42:33; 43:13; 45:13
<b>Dexhalli:</b> (Anti-Krishti)	18:111; 40:58; 21:97
<b>Dëlrirët (të):</b> të dëlrirët, të sinqertët ( <i>salihin</i> ) Allahu është mik i tyre	45:20; 3:77; 9:4, 7
<b>Dëshmia:</b> vërtetues	2:284; 2:141; 5:107-108
e të Dërguarve	3:82; 2:102; 3:40, 51; 5:47; 61:7
e skripteve	2:42; 2:90, 98; 3:4; 4:48; 5:47, 49; 6:93; 35:32; 46:13

<b>Dëshmorët:</b> martirët	2:155; 3:158, 170-172; 47:5-7
<b>Dielli:</b> dielli dhe hëna	25:62; 2:190; 6:97; 7:55; 10:6; 13:3; 14:34; 16:13; 21:34; 22:19; 25:46-47; 31:30; 35:14; 36:39-41; 39:6; 41:38; 55:6; 71:17; 75:8-10; 78:14; 84:17-19; 91:2-3
<b>Dija:</b> që dhuron Allahu	20:115; 2:248; 12:77; 21:80; 22:55; 28:81; 33:64; 35:29; 39:10; 47:32; 58:12
ki druajtje ndaj Allahut, Allahu të mëson, të jep dije	2:283; 35:29
dija e Allahut	20:111; 2:30, 33, 256, 274; 3:120; 4:33; 6:81, 102; 7:188; 20:99; 29:4; 31:35; 33:64; 43:5, 86; 57:4
dija dhe besimtarët	4:163; 2:248; 3:8; 6:36, 58, 98, 106; 12:23, 56, 69, 109; 15:76; 16:28; 17:108; 22:55; 28:81; 29:48, 50; 30:57; 31:16; 34:7; 58:12
dija dhe ata që nuk besojnë	2:248; 3:8; 6:36, 58, 98, 106; 12:23, 56, 69, 109; 15:76; 16:28; 17:108; 22:55; 28:81; 29:48, 50; 30:57; 31:16; 34:7; 58:12
dija dhe Profeti	7:158; 3:62; 29:49; 38:70; 53:15; 67:27
dija dhe të paditurit	16:120; 6:109, 141, 145; 16:26; 22:4, 9; 30:30; 31:7; 39:10; 102:6
dija dhe njeriu	39:50; 9:11; 27:66-67; 55:3; 96:5-6; 102:6
dija dhe të Dërguarit	18:66; 2:32; 3:180; 12:23, 56, 69, 109; 15:54; 19:44; 21:75, 80; 27:16-17; 28:15; 51:29
dija në moshë të thyer	16:71; 22:6; 36:69
përhapja e saj	9:122; 2:152; 18:66-67
dija e së padukshmes	35:39; 6:60; 5:110; 5:116; 9:79; 34:49; 2:34; 3:45; 6:74; 9:95; 9:106; 13:10; 18:27; 23:93; 28:66; 32:7; 39:47; 49:19; 59:23; 62:9; 64:19; 27:76; 16:78; 10:21; 52:42; 53:36; 68:48; 59:23
<b>Dijetarët:</b> cilët janë dijetarët e vërtetë?	35:29; 3:8
<b>Dita e Gjykimit:</b> Dita e Kiametit, Dita e <i>Ahiretit</i> , Dita e Ringjalljes	37:21; 1:4; 2:9, 49, 86, 114, 127; 3:78, 115; 4:40, 142; 5:70; 6:13; 9:18; 11:27; 14:32, 43; 15:36; 23:102; 24:3, 38; 25:27; 26:83, 88; 29:37; 30:57; 33:22; 38:80; 43:66; 44:17; 50:45; 51:13; 60:4; 70:9; 74:9-10; 75:2-3; 82:17-18; 83:11-12; 86:10
besimi në të	70:27; 2:5, 178, 233; 3:115; 4:60, 137, 163; 5:70; 12:38; 18:106; 21:50; 27:4; 31:5; 74:44-47; 83:12
besimtarët atë ditë	39:74; 2:213; 19:73, 86; 23:103; 26:91; 43:36, 68; 44:52; 50:32; 101:7-8
fytyrat e besimtarëve atë ditë	3:107; 10:27; 75:23; 88:9-10

» <b>Dita e Gjykimit:</b> fytyrat e mohuesve atë ditë	67:28
qiejt dhe toka atë ditë	39:68; 27:88-89; 36:52; 39:69; 50:43, 45; 52:10-17; 75:7-12
e pashmangshme	6:13; 6:32; 12:108; 15:86; 18:22; 20:16; 22:8, 56; 34:4; 40:60; 42:8; 43:67; 45:33; 47:19; 51:7; 56:3
dija e saj është tek Allahu	79:43-45; 7:188; 31:35; 33:64; 41:48; 43:86
lutje për të pasur falje atë ditë	3:195; 11:48; 14:42; 26:83
ndëshkimi atë ditë	22:10; 2:175; 3:78, 181; 5:37; 7:168; 11:61, 99-100; 15:36; 16:26, 28; 17:98; 20:101; 20:125; 25:70; 28:42, 62; 29:14; 29:26; 39:16, 25; 39:48, 61; 41:41; 42:46; 82:16
mohimi i saj	4:137; 6:32; 7:46, 148; 11:20; 16:23, 61; 17:11; 23:75; 25:12; 27:5-6; 30:17; 34:9; 41:8; 83:11-12
drejtësia atë ditë	17:14-15; 2:114; 3:186; 4:142; 10:94; 16:125; 21:48; 22:18, 70; 32:26; 45:18; 60:4
mëkatarët atë ditë	17:98; 18:106; 19:87; 20:125; 23:104; 54:49; 55:42; 101:9-10
<b>Dita e premtë:</b>	62:10
<b>Ditë e natë:</b>	2:165; 3:28; 21:34; 91:4; 92:3
<b>Ditët:</b> ( <i>ejjam</i> )	8:55; 2:42; 3:114; 8:3; 13:2; 16:102; 19:59; 22:17; 39:72
<b>Divorci:</b> metoda e saktë; kur është i kthyeshëm, kur i pakthyeshem	2:230-231; 2:228-235; 2:237-238, 242; 33:50; 65:2-8
e lejuara më e urryer	2:30
ndarja duhet bërë në mënyrë të denjë	33:50; 2:242; 4:21-22; 65:2-3, 7-8
Islami i jep edhe gruas të drejtën e divorcit	2:230
paralajmërim për burrat që divorcojnë gratë e tyre padrejtësisht	2:228
“fëmijën mos e bëni mjet për t’i ushtruar presion njëri-tjetrit”	2:234
për atë që betohet për të mos shkuar me gruan e tij ( <i>ilā</i> )	2:227
për ata që bëjnë <i>dhihar</i> (zakon arab)	33:5; 58:3-5
në rast se bashkëshortët fajësojnë njëri-tjetrin për tradhti, dhe nuk kanë dëshmitar ( <i>malkimi</i> )	4:7-11
<b>Djali:</b>	Shih: <b>Iblisi dhe Shejtani</b>
<b>Drejtësia:</b> urrejtja për dikë nuk duhet të të ndalojë të bësh drejtësinë	5:9

» <b>Drejtësia:</b> ndëshkimi të jetë me drejtësi	16:127; 42:41
lufta derisa të bëhet drejtësi	49-10
zgjidh të drejtët	5:107; 5:96
hakmarrja vetëm përmes drejtësisë	6:152; 25:69; 42:41
matni dhe peshoni me drejtësi	6:153; 7:86; 11:85-86; 17:36; 26:182183; 55:10; 83:3-4
porosi për Profetin	4:66; 5:43
Allahu i do ata që bëjnë drejtësi	5:43
<b>Drita:</b>	24:36-37; 2:258; 4:175; 5:16-17, 45-47; 6:2, 92, 123; 7:158; 9:32; 10:6; 13:17; 14:2, 6; 24:41; 33:44; 35:20-21; 39:23, 70; 42:53; 57:10, 13-14, 29; 61:9; 64:9; 65:12; 71:16-17
<b>Druajtja:</b> Druajtja ndaj Allahut; të druajturit ndaj Allahut	2:3; 2:190, 197-198, 204, 213, 224, 232, 234, 238, 279, 283-284; 3:16, 51, 77, 103, 131, 201; 4:2, 10, 132; 5:3, 5, 8-9, 12, 36, 58, 89, 94, 97, 113; 6:70, 73; 7:27, 36, 66; 8:2, 70; 9:7, 108, 109; 11:79; 15:70; 20:133; 22:2, 33, 38; 26:109, 133, 185; 33:56, 71; 43:64; 47:18; 48:27; 49:4, 11, 13; 57:29; 58:10; 59:8, 19; 60:12; 65:2, 11; 74:57; 78:32; 96:13 Shih edhe: <b>Frika</b>
kuptimi gjuhësor i <i>takvasë</i>	2:3
Allahu është mik i atyre që e kanë	45:20; 3:77; 9:4, 7;
përkrahimi i të druajturve ndaj Allahut	2:178; 2:4-5; 3:115, 180; 16:129; 20:83; 22:33; 39:34; 51:16-19;
detyrat e atyre që kanë druajtje	22:38; 6:70; 58:10; 5:9; 6:70; 6:87
veshja e druajtjes	7:27
druajtja si ushqim dhe dritë gjatë rrugëtimit shpirtëror	2:198; 57:29
<b>Dunat:</b> (Ahkafi)	46:22
<b>Durimi:</b>	Shih edhe: <b>Morali</b>
dhe ndihma e Allahut	2:154; 2:156, 250; 3:147; 8:47, 67; 11:12; 21:86
urdhëresa për të	2:46; 2:154; 3:201; 7:88, 129; 8:47; 12:19; 18:29; 31:18; 42:44
dhe Profeti <sup>savs</sup>	16:127-128; 10:110; 11:50, 116; 18:68-69, 73; 20:131; 30:61; 38:18; 40:56, 78; 46:36; 50:40; 52:49; 68:49; 70:6; 73:11; 74:8; 76:25
shenjë e besimtarit	3:18; 2:178; 3:187; 14:6; 16:127; 21:86; 22:36; 31:32; 33:36; 37:103; 54:28
shpërblimi për të	16:111; 7:138; 11:12; 13:23, 25; 16:43, 97, 127; 23:112; 25:76; 28:55; 29:60; 41:36; 76:13
<b>Dhul-Karnejni:</b>	18:84-99

<b>Dhulkifli</b> <sup>as</sup> :	21:86; 2:260; 38:49-50
<b>Egjpt:</b> ( <i>Misr</i> ); qytet	12:22; 7:130; 12:100; 16:88; 43:52
<b>Ejubi</b> <sup>as</sup> :	6:85; 4:164; 21:84-85; 38:42-45
<b>Eklipsi:</b>	75:9; 54:2; 75:10; 81:3
<b>Ekonomia:</b> në pasurinë tuaj ka pjesë edhe ai që është në nevojë	51:20
paratë nuk duhet të qarkullojnë vetëm në duart e të pasurve	59:8
ndalimi i kamatës	2:279; 2:276-277; 2:279-281; 30:40; 3:131; 4:162
hua; borxh	2:279; 2:281-284; 4:12-13
hua e bukur	2:246; 5:13; 57:12, 19; 64:18; 73:21
ndalimi i kumarit (i bixhozit)	2:220; 5:91
lejohet fitimi prej tregtisë	4:30
analizë e tregtisë së sotme	f. 1112
në tregti, palët duhet të kenë dakordësi	4:30
në tregti duhet të ketë dëshmitar dhe procesverbal	2:283
tregtia nuk i pengon dot njerëzit me spiritualizëm të lartë nga namazi e zekati	24:38; 62:10-12
tregti që kurrë nuk humbet	35:30
përbushni masën dhe peshën me drejtësi	6:153; 7:86; 17:36; 26:182-183; 55:9-10
tregtia ( <i>tixharet, bej'u</i> )	2:276; 2:17, 199; 3:134; 4:30; 9:24, 74; 24:38; 35:30; 61:11-12; 62:12; 2:255, 283; 9:111; 14:32; 24:38; 62:10
mësimi i artë për shpenzime	25:68; 17:30
paralajmërim për shtetet lakmitare që grumbullojnë pasurinë	f. 1172
ryshfeti: ndalimi i tij për t'ia marrë të drejtën tjetrit	2:189
ekonomia (të tjera)	2:216, 266, 269, 270, 274, 276; 9:103; 16:72; 89:18-21; 99:3; 104:3
<b>Elefanti:</b> të zotët e elefantëve	105:2
<b>Eljesai</b> <sup>as</sup> : (Eliseu)	38:49; 6:87
<b>Emrat e Allahut:</b> Falja   <i>El-Afuw</i>	4:150; 4:44, 100; 22:61; 58:3
i Vetmi   <i>El-Ehad</i>	112:2; 2:164, 256; 4:172; 5:74; 16:23; 122:35; 37:5; 59:23-24
i Fundit   <i>El-Akhir</i>	57:4

» <b>Emrat e Allahut:</b> më i Nderuari; Bujari   <i>El-Ekrem</i>	96:4
i Larti   <i>El-Alij</i>	4:35; 2:256; 22:63; 31:31; 34:24; 40:13; 42:5, 52
i Gjithëdijshmi   <i>El-Alim</i>	19:2; 2:116, 128, 138, 159, 182, 228, 245, 257, 262, 269, 274; 3:93; 4:12, 36, 71, 171; 6:14, 116; 9:15, 28; 15:87; 22:60; 24:22, 42; 33:41, 52; 34:27; 35:39, 45; 36:39; 40:3; 57:4, 7; 59:23; 64:12
i Pari   <i>El-Evvel</i>	57:4
i Madhërishmi   <i>El-Adhim</i>	42:5; 2:256; 56:75, 97
Triumfuesi   <i>El-Aziz</i>	4:57;2: 130, 210, 221, 229; 3:7, 19; 4:159, 166; 9:40, 71; 14:2; 16:61; 22:41, 75; 26:192; 27:10, 79; 33:26; 34:7; 35:29; 38:10, 67; 40:3; 45:3; 46:3; 48:8, 20; 59:2, 24; 61:2; 62:2; 64:19
Nismëtari   <i>El-Bari</i>	2:118; 6:102; 10:5, 35; 21:105; 27:65; 29:20; 30:12, 28; 85:14
Ngritësi   <i>El-Baith</i>	2:57; 2:260; 5:13; 6:37; 17:6; 22:8
i Përhershmi   <i>El-Baki</i>	20:74; 55:28
Mirëbërësi   <i>El-Berr</i>	52:29
Filluesi   <i>El-Bariu</i>	59:25; 2:55
Vështruesi   <i>El-Basir</i>	4:135; 2:97; 4:59; 17:2; 22:76; 40:21, 57; 42:12, 28; 57:5; 60:4; 67:20
Dhënësi   <i>El-Basit</i>	13:27; 2:246; 17:31; 28:83; 29:63; 30:38; 34:37; 39:53; 42:13, 28
i Padukshmi   <i>El-Batin</i>	57:4
Shpërthyesi   <i>El-Falik</i>	6:96; 6:97; 26:64; 113:2
Gjykatësi më i mirë; Hapësi   <i>El-Fettah</i>	34:27
Gjithëfalësi   <i>El-Ghaf-far</i>	38:67; 20:83; 39:6; 40:43; 71:11
Falësi   <i>El-Ghafur</i>	22:61; 2:174, 183, 193, 200, 219, 226, 227, 236; 4:24, 44, 97, 100-101; 5:99; 8:70; 9:5; 16:111; 17:26, 45; 18:59; 25:7, 71; 33:6, 25, 51, 74; 34:16; 35:35, 42; 41:33; 42:6, 24; 48:15; 58:3; 60:8, 13; 64:15; 85:15
i Pasuri   <i>El-Ganij</i>	2:268; 2:264; 3:98; 4:132; 6:134; 9:28; 10:69; 14:9; 22:65; 27:41; 29:7; 31:13, 27; 35:16; 39:8; 47:39; 57:25; 60:7; 64:7
Udhërrëfytyesi   <i>El-Hadi</i>	19:2; 22:55; 25:32
Ruajtësi   <i>El-Hafidh</i>	34:22; 11:58; 42:7
i Vërteti   <i>El-Hakk</i>	22:63; 6:63; 10:33; 20:115; 22:7; 23:117; 24:26; 31:31
i Gjalli   <i>El-Hajj</i>	3:3; 2:256; 20:112; 25:59; 40:66



» <b>Emrat e Allahut:</b> Gjykatësi   <i>El-Hakem</i>	22:70; 2:214; 4:142; 39:47; 42:11; 60:11
i Urti   <i>El-Hakim</i>	2:130; 2:33, 210, 221, 229, 261; 3:7; 4:12, 57, 131, 166; 5:119; 9:15, 40; 11:2; 12:101; 15:26; 16:61; 22:53; 24:19; 27:7, 10; 31:28; 34:2; 35:3; 41:43; 42:52; 43:85; 44:5; 46:3; 48:5, 8, 20; 49:9; 57:2; 59:2, 25; 62:2; 64:19; 66:3
i Përmbajturi   <i>El-Halim</i>	2:226; 2:236, 264; 17:45; 22:60; 33:52; 35:42; 64:18
i Lavdëruari   <i>El-Hamid</i>	22:65; 2:268; 4:132; 11:74; 14:2, 9; 22:25; 31:13, 27; 41:43; 42:29; 60:7; 85:9
Llogaritësi   <i>El-Hasib</i>	4:7; 3:200; 4:87; 33:40
Ndreqësi   <i>El-Xhebbar</i>	59:24
Tubuesi   <i>El-Xhami'</i>	34:27; 3:10, 26; 4:88; 45:27
i Madhi   <i>El-Kebir</i>	4:35; 13:10; 22:63; 31:31; 34:24; 40:13
i Mjaftueshmi   <i>El-Kafi</i>	19:2; 2:138; 4:7, 46; 39:37
i Nderuari, Bujari   <i>El-Kerim</i>	27:41; 82:7
i Gjithinformuari   <i>El-Khabir</i>	6:104; 2:272; 4:36, 136; 5:9; 6:19, 74; 11:2; 17:18, 31; 22:64; 31:17; 33:35; 35:15, 32; 42:28; 49:14; 57:11; 58:14; 59:19; 63:12; 64:9; 66:4; 67:15; 100:12
Krijuesi   <i>El-Khalik</i>	59:25; 6:103; 13:17; 15:87; 23:15; 36:82; 37:126; 39:63; 40:63; 56:60; 57:5
i Mprehti, i Paformi   <i>El-Latif</i>	6:104; 12:101; 22:64; 31:17; 33:35; 42:20; 67:15
Shtruesi   <i>El-Mahid</i>	51:49
i Lavdishmi   <i>El-Mexhid</i>	85:16; 11:74; 40:2
Sunduesi   <i>El-Malik</i>	59:24; 1:4; 20:115; 22:57; 23:117; 25:27; 54:56; 62:2; 114:3
i Forti   <i>El-Metin</i>	51:59
Vonuesi (që shtyn afatin e ndëshkimit)   <i>El-Muakh-khir</i>	71:5
Nismëtari   <i>El-Mubdi</i>	10:35; 10:5; 21:105; 27:65; 29:20; 30:12, 28; 85:14
Nënshtruesi   <i>El-Mudhil</i>	3:27
Strehuesi   <i>El-Muhejmin</i>	59:24
Jetëdhënësi   <i>El-Muhji</i>	30:51; 2:29; 3:157; 7:159; 15:24; 22:67; 30:41; 40:12, 69; 45:27; 57:3
Numëruesi   <i>El-Muhsi</i>	78:30; 18:50; 58:7
Përsëritësi   <i>El-Muid</i>	10:35; 10:5; 21:105; 27:65; 29:20; 30:12, 28; 85:14

» <b>Emrat e Allahut:</b> Nderuesi   <i>El-Muiz</i>	3:27
Pranuesi   <i>El-Muxhib</i>	11:62; 3:196; 37:76
Paqedhënësi   <i>El-Mumin</i>	59:24
Vdekjdhënësi   <i>El-Mumit</i>	57:3; 3:157 ; 7:159; 15:24; 40:69; 44:9; 50:44
Bekuesi   <i>El-Munim</i>	1:7; 4:70; 5:21; 19:59; 89:16
Ndëshkuesi   <i>El-Muntekim</i>	3:5; 14:48; 32:23; 39:38; 43:42; 44:17
Ushqyesi   <i>El-Mukit</i>	41:11; 4:86
Fuqiploti   <i>El-Muktedir</i>	54:43; 18:46; 54:56
Formuesi   <i>El-Musavvir</i>	3:7; 59:25
Atij që i kërkohet ndihmë   <i>El-Mustean</i>	12:19
i Lartësuar   <i>El-Muteali</i>	13:10; 87:2; 92:21
Krenari   <i>El-Mutekebbir</i>	59:24
Ndihmësi   <i>El-Nasir</i>	4:46; 2:108; 4:174; 8:41; 25:32; 33:18; 47:14
Drita   <i>En-Nur</i>	24:36
Shtrënguesi   <i>El-Kabid</i>	2:246
i Plotfuqishmi   <i>El-Kadir</i>	35:45; 2:149, 285; 4:150; 5:41; 16:71; 22:7; 25:55; 30:55; 57:3; 64:2
i Afërti   <i>El-Kerib</i>	34:51; 2:187; 11:62
i Qëndrueshmi   <i>El-Kajjum</i>	3:3; 2:256; 20:112; 55:27
i Shenjti   <i>El-Kuddus</i>	59:24; 62:2
Zoti   <i>Er-Rab</i>	1:2; 2:22; 4:2; 5:29, 73, 118; 6:2, 46, 165; 10:11; 22:78; 39:76; 45:37
Lartësuesi   <i>Er-Rafii</i>	3:56; 2:254; 4:159; 7:177; 19:58; 24:37; 27:16; 35:11; 40:16
i Gjithëmëshirshmi   <i>Err-Rrahman</i>	1:1-4; 12:65; 13:31; 17:111; 19:45, 46, 59, 62, 86; 21:113; 25:61; 26:6; 27:31; 36:53; 41:3; 50:34; 55:2; 59:23; 67:30; 78:39
Mëshirëbërësi   <i>Err-Rrahim</i>	1:1-4; 2:161, 164, 174, 183, 193, 219, 227; 3:32; 4:24, 97, 101; 5:4, 99; 11:42; 12:54; 18:59; 26:192; 27:31; 30:6; 33:44; 36:59; 42:6
Vëzhguesi, Mbikëqyrësi   <i>Er-Rekib</i>	33:53; 4:2; 5:118
Udhëzuesi   <i>Er-Reshid</i>	18:18; 18:11
i Dhembshuri   <i>Er-Reuf</i>	3:31; 2:208; 9:117; 24:21; 57:10; 59:11
Furnizuesi   <i>Er-Rezzak</i>	22:59; 51:59; 62:12
i Vërteti   <i>Es-Sadik</i>	19:2; 4:88, 123; 6:147; 27:50
Paqja   <i>Es-Selam</i>	59:24
i Pavaruri   <i>Es-Samed</i>	112:3

» <b>Emrat e Allahut:</b> Dëgjuesi   <i>Es-Semi</i>	2:182; 2:128, 138, 228, 245, 257; 4:59, 135, 149; 6:14, 116; 8:18, 43; 22:62; 24:22, 61; 40:21; 42:12; 49:2
Shëruesi   <i>Esh-Shafi</i>	26:81
Ndërmjetësi   <i>Esh-Shefi</i>	6:52; 6:71; 32:5
Dëshmitari   <i>Esh-Shehid</i>	4:80; 3:99; 4:167; 6:20; 13:44; 22:18; 29:53; 33:56; 34:48; 41:54; 48:29
Mirënjohësi   <i>Esh-Shekur</i>	64:18; 2:159; 4:148; 35:31, 35; 42:24
Pendimpranuesi   <i>Et-Teuab</i>	42:26; 2:38, 55, 129, 161; 4:17, 65; 9:104; 24:11; 49:13; 110:4
i Dashuri   <i>El-Vedud</i>	11:91; 85:15
Dhuruesi   <i>El-Vehhab</i>	3:9; 38:10, 36
Njëshi   <i>El-Vahid</i>	13:17; 2:134, 164; 5:74; 9:31; 16:23; 18:111; 22:35; 37:5; 38:66; 39:5; 112:2
i Vetmi   <i>Ehad</i>	112:2; 13:17
Kujdestari   <i>El-Vekil</i>	3:174; 4:82, 133, 172; 6:103; 11:13; 17:3, 66, 69; 28:29; 33:4, 49; 73:10
Miku   <i>El-Velij</i>	12:102; 2:108, 258; 3:69; 4:46, 174; 7:197; 33:18, 66; 42:10, 29, 32; 45:20
Trashëguesi   <i>El-Varith</i>	15:24; 19:41; 21:90; 28:59
Zgjeruesi   <i>El-Vasi</i>	4:131; 2:116, 262, 269; 3:74; 5:55; 24:33
i Dukshmi   <i>Edh-Dhahir</i>	57:4
Ai qëndron mes njeriut dhe zemrës së tij	8:25
<b>Engjëjt:</b> Allahu zgjedh të dërguar prej tyre	22:76
armiqësia me ta është armiqësi me Allahun	2:99
a është Zoti nevojtar i tyre? qëllimi i krijimit të tyre	35:2
si shenjë	25:8; 6:9; 11:13; 15:8; 17:93
dëshmojnë	4:167; 3:19
besimi në ta	2:286; 2:178; 4:137
te Zekerija dhe te Merjemja	3:40; 3:43, 46; 19:10, 18
zbresin pranë atyre që janë të qëndrueshëm dhe të palëkundur	41:31-32; 97:5
mohojnë adhurimin e adhuresve të tyre	34:41-42
nuk janë mosbindës ndaj Allahut	16:50-51; 7:207; 19:65; 66:7
nuk e kundërshtuan Allahun për krijimin e Ademit	2:31
detyrat e tyre	16:3; 6:112; 13:12; 15:9; 35:2; 38:74; 39:76; 42:6;

» <b>Engjëjt:</b> Paria e Lartë	38:70
Xhibraili dhe Mikaili	2:98-99; 66:5
paralajmërues të ndëshkimit të Zotit	6:9; 2:211; 6:159; 15:9; 25:8, 23, 26; 89:23; 96:19
Haruti dhe Maruti	2:103
ndihmojnë besimtarët	8:10; 2:211; 3:124-127; 8:13; 41:31-32
Jusufi si një engjëll fisnik	12:32
nuk janë bijat e Allahut	37:150-51; 17:41; 43:20
engjëlli i vdekjes ( <i>melekul-meut</i> )	32:12
engjëlli i xhehenemit	43:78
nuk dinë më shumë sesa i mëson Allahu	2:31-33
rojtare të xhehenemit	74:32
mekasit i kërkonin si shenjë	17:93
luten për Profetin Muhammed dhe i dërgojnë <i>salavatet</i> atij	33:44; 33:57
shënojnë veprat e njeriut	50:18-19; 82:11-12; 10:22; 43:81; 86:5; 6:62
sexhdeja e tyre për Ademin	38:73-74; 2:35; 7:12; 15:30-31; 17:62; 18:51; 20:117
ua marrin shpirtin njerëzve kur u vjen koha e vdekjes	22:6; 4:98; 5:118; 16:29, 33; 32:12; 6:61-62; 7:38; 8:51; 10:47, 105; 12:102; 13:41; 16:71; 39:43; 40:68, 78; 47:28
engjëlli grahës dhe ai dëshmitar	50:22; 50:25
<b>Ensar:</b> muslimanët e Medinës	59:10; 2:271; 3:53, 193; 8:75-76; 9:100, 117; 61:15; 71:26
<b>Era:</b> si bekim dhe shenjë e mirë	27:64; 2:165; 7:58; 15:23; 24:44; 25:49; 30:47, 49; 35:10; 38:37; 42:34; 45:6
si një forcë e natyrës	33:10; 21:82; 34:13; 38:37
në kuptimin alegorik	18:46; 3:118; 14:19; 22:32
ndëshkim	10:23; 14:19; 17:69-70; 18:46; 22:32; 29:41; 41:17; 54:20, 35; 67:18; 69:6-7
fenomen shpirtëror	51:2-4;
të ndryshme	67:18; 14:19; 15:23; 17:70; 38:37; 41:17; 46:25; 54:20; 69:7
<b>Erëza:</b> xhenxhefil	76:18
kripë	25:54; 35:13
sinap	21:48; 31:17
<b>Errësira:</b>	2:18; 2:20, 258; 5:17; 6:2, 40, 60, 123; 10:27; 13:17; 14:2, 6; 24:41; 33:44; 35:21; 57:10; 65:12; 93:3

<b>Etika:</b> etika pranë Profetit <sup>savs</sup>	33:54; 24:64; 49:2-3; 58:13-14
për mbledhjet	24:63; 4:141; 6:69; 58:12
për privatësinë	24:28-32; 2:190; 24:59-61; 33:60; 33:54
në shoqëri	31:20; 2:84; 6:153; 41:35; 24:62; 4:87; 49:12; 5:7; 7:27, 32; 49:2-7; 31:20; 25:64; 7:32
<b>Evolucioni:</b>	1:2; 22:6; 23:13-15; 32:8-10; 56:61-62; 71:15, 18; 95:2-6; Shih edhe: <b>Njeriu</b>
evolucioni jo me rastësi, por i projektuar	1:2;
seleksionimi natyror; Zoti e ka bërë edhe krijimin, edhe seleksionimin	28:69-74
bakteret e para ishin krijuar prej zjarri	15:28
<b>Ëndrra:</b>	6:112; 8:44; 12:5, 6, 37-38, 44-50, 101-102; 17:61; 21:6; 37:103, 106; 48:28 Shih edhe: <b>Komunikimi me Zotin</b>
<b>Falja:</b> ( <i>afvu</i> )	
Allahu fal	3:136-137; 2:222, 269; 3:133; 4:97; 8:5; 22:51; 24:27; 33:36; 34:5; 35:8; 36:12; 47:16; 48:30; 49:4; 67:13
Profetët kërkojnë falje	19:48; 7:24, 152, 156; 9:114; 14:42; 26:87; 28:17; 38:36; 60:5-6; 71:29
Allahu nuk e fal <i>shirkun</i>	4:49; 4:117; 5:73-74
Ai fal kë të dojë	48:15; 2:285; 3:130; 4:117; 5:19, 41
falja e mëkatit	3:32; 3:136; 4:18, 49, 111, 117; 39:54
lutje për faljen e mëkateve	3:194-195; 2:287; 3:17, 148; 11:48; 14:42; 23:110, 119; 26:83; 59:11; 66:9
Allahu premtoi falje	48:30; 2:269; 3:137; 8:5; 22:51; 24:27; 33:36; 34:5; 35:8; 36:12; 47:16; 49:4; 67:13
kërkojini falje Allahut	11:53; 2:200; 3:136; 4:65, 107, 111; 5:75; 8:34; 11:4, 91; 40:56; 41:7; 47:20; 66:9; 71:11; 73:21; 110:4
<b>Familja:</b>	11:46-47
<b>Familja e Profetit:</b> <i>Ehli Bejti</i>	33:34; 11:46-47, 74; 28:13
<b>Faraoni:</b> historia e tij	11:99-100; 3:12; 7:131; 8:55; 10:91; 28:42-43; 40:47; 44:30; 54:42-43; 73:17; 79:25-26
gruaja e tij	66:12
mendjemadhësia e tij	28:39-40; 40:27, 37-38; 43:52-53; 44:32; 51:40-41; 79:21-25
ndëshkimi i tij	11:99-100; 3:12; 7:131; 8:55; 10:91; 28:42-43; 40:47; 44:30; 54:42-43; 73:17; 79:25-26
poshtërimi i tij	44:30; 10:91; 11:100; 28:43

» <b>Faraoni:</b> mbytja e tij	2:51; 8:55; 10:91; 17:104; 20:79; 26:67; 28:41; 43:56; 44:25; 51:41
ruajtja e trupit të tij	10:92-93
<b>Fati i keq:</b>	2:157; 3:166; 4:73; 5:53; 7:151; 9:50; 38:42; 42:31
<b>Fëmijët:</b> si sprovë	64:16; 8:29; 18:47; 19:78; 34:36; 57:21
ata që urrejnë të kenë vajzë	16:59-60
të kujdesen për prindërit	17:24-25; 46:16, 18
mos i vritni	17:32; 6:138, 141, 152
fëmijë	3:41; 12:20; 15:54; 18:75, 83; 19:8-9, 21; 37:102; 51:29; 52:25
lutjet për ta	14:36; 2:129; 3:39; 25:75; 46:16
nuk do të sjellin dobi	34:38; 26:89; 3:11, 117; 9:69; 58:18; 60:4
nuk duhet t'ju largojnë nga përkujtimi i Allahut	63:10; 18:47
<b>Fjalët:</b>	3:46; 2:38, 125; 3:40, 65; 4:172; 6:35, 116; 7:138, 159; 8:8; 9:40, 74; 10:20, 34, 65, 97; 11:111; 14:25, 27; 18:6, 28, 110; 20:130; 23:101; 31:28; 37:172; 39:20, 72; 40:7; 42:15, 22; 43:29; 48:27; 66:13
<b>Frika:</b> frika ndaj Allahut ( <i>khashijetullah</i> )	8:49; 2:151; 5:4, 29, 45; 7:57; 9:13, 18, 109; 12:110; 13:22; 14:15; 16:52; 17:58; 20:4; 21:50; 23:3, 58, 61; 24:53; 33:38, 40; 35:19, 29-30; 36:12; 39:11, 21, 24; 49:2; 50:34; 55:47; 59:17; 67:13; 79:27, 41, 46; 80:10; 87:11; 98:9 Shih edhe: <b>Druajtja</b>
besimtarët që kanë frikë ndaj Allahut edhe kur janë vetëm	21:50; 35:19; 36:12; 50:34; 67:13; 5:95; 57:26
frika ( <i>khauf</i> )	106:5; 2:39, 63, 113, 156, 263, 275, 278; 3:171; 5:70; 6:49, 52; 7:36, 50, 57, 206; 10:63; 12:58; 13:13, 22; 16:51; 17:58; 24:38; 30:25; 32:17; 43:69; 46:14; 74:54; 76:8
në zemrat e mohuesve	8:13; 2:20, 67, 207; 3:176; 8:27, 57; 33:20; 34:52; 42:23; 106:5
në xhami duhet të hysh duke pasur frikë	2:115
besimtarët nuk kanë frikë	2:63; 2:75, 113, 181, 263, 275, 278; 3:171, 174, 199; 5:55, 70; 6:16, 49, 52, 81-82; 7:50; 10:63; 24:56; 36:12; 41:31; 43:69; 46:14; 72:14
frika e varfërisë	17:32; 6:152; 9:24, 28; 16:113; 17:101
namazi i frikës	2:240; 4:102-103
frika si sprovë	2:156
<b>Froni:</b> Froni i Allahut	Shih: <b>Arshi</b>
froni i Shebës	27:24; 27:42-43

» <b>Froni:</b> froni i Jusufit <sup>as</sup>	12:101
<b>Fruta:</b> shega	6:100; 6:142; 55:69
rrushi	2:267; 6:100; 13:5; 16:12; 16:68; 17:92; 18:33; 23:20; 36:35; 78:33; 80:29
fiku	95:2
banania	56:30
ulliri	6:100; 6:142; 16:12; 24:36; 80:30; 95:2; Shih edhe: <b>Ulliri</b>
hurma	2:267; 6:100; 6:142; 13:5; 16:12; 16:68; 17:92; 18:33; 19:24; 19:26; 20:72; 23:20; 26:149; 36:35; 36:40; 50:11; 54:21; 55:12; 55:69; 59:6; 69:8; 80:30
<b>Fuqia:</b> e Allahut	2:21; 2:107, 166; 3:30; 5:18, 121; 6:18; 7:189; 9:39; 10:50; 11:5, 67; 18:40; 22:41, 75; 33:26; 40:23; 42:20; 51:59; 53:6-7; 57:26; 58:22
e të tjerëve përpos Allahut	5:77; 16:74; 17:57
<b>Gradat:</b> gradat shpirtërore sipas veprave	3:164; 4:97; 6:84, 133, 166; 8:5; 12:77; 17:22; 20:76; 43:33; 46:20; 58:12;
për ata që përpiqen shumë	9:20; 57:11
mes Profetëve	2:254
<b>Gratë:</b>	4:2; 4:22, 35; 2:188, 223-224, 234; 3:15; 4:8, 20, 26, 35, 36, 128-131, 177; 16:59-60; 24:32, 61; 33:60; 60:13; 65:7-8 Shih edhe: <b>Martesa, Divorci, Bashkëshortet, Poligamia</b>
barazia	4:33; 33:36; 4:125; 2:229; 3:196; 4:8, 16:98; 40:41
A lejon Islami burrin të keqtrajtojë gruan e tij?	4:35
pse burrat janë quajtur “kujdestarë” të grave?	4:35
të vejat	2:241; 2:235-236; 4:20; 33:51
<b>Gratë e Profetit:</b>	Shih: <b>Muhammedi</b>
<b>Gjdhënia:</b>	2:234; 31:15; 2:234, 4:24
<b>Gjuetia:</b>	5:5; 5:96-97
<b>Gjuha:</b> gjuhët, të folurit	30:23; 14:5; 16:104; 19:98; 26:195-196; 28:35; 44:59; 46:13; 38:24
gjuha si organ	5:79 3:79; 4:47; 7:177; 16:63, 104, 117; 19:51, 98; 20:28; 24:16, 25; 26:14, 85, 196; 30:23; 33:20; 41:45; 42:8; 44:59; 48:12; 60:3; 75:17; 90:10
<b>Gjumi:</b>	3:56; 2:256; 3:155; 6:97; 25:48; 30:24; 39:43; 78:10

<b>Hadithi:</b> “hadithi” që bie ndesh me Kuranin, interpretohet ose refuzohet	6:165; 45:7; 33:22
Kurani, suneti dhe hadithi; dallimi mes sunetit dhe hadithit	33:22
Sahabët e gjykonin hadithin në dritën e Kuranit	6:165
profeci që në të ardhmen haditheve do t’u jepej më shumë rëndësi sesa Kuranit	45:7; 25:31
për ata që nuk i besojnë fare hadithet	4-151-153
<b>Hallall:</b> gjërat e lejuara	2:169; 2:174, 188, 276; 2:220; 4:24-25; 5:2, 5-6, 88, 89, 97; 6:119-120; 8:70; 10:60; 16:115, 117; 66:2
<b>Haram:</b> gjërat e ndaluara	2:174; 2:276; 4:24, 25; 5:4, 73, 88; 6:120, 122, 146, 152; 7:33-34, 51, 158; 16:116; 17:34; 25:69; 66:2
pse është i ndaluar mishi i derrit?	5:4.
a lejohet mishi që ka gatuar një i krishterë?	5:6
pse janë të ndaluara alkooli dhe bixhozi?	2:220
dehja, pirja e alkoolit, lëndët narkotike	2:220; 5:91-92
<b>Haruni<sup>as</sup>:</b> i dërguar te Faraoni	10:76; 20:44; 26:16
mirësitë e Zotit mbi të	37:115-121
zëvendës i Musait	7:134; 20:30-37; 25:36; 26:14-16; 28:35-36
lutja e Musait për të	7:152
profetëria e tij	4:164; 6:85; 10:76; 19:54; 21:49; 23:46; 25:36
i dërguar me shenja dhe argumente	23:46; 20:30-36
Allahu i dha dalluesin, dritën dhe këshillën	21:49
qortimi i Musait dhe arsyetimi	7:151; 20:93-94
Kurani hedh poshtë akuzat ndaj tij duke thënë se ç’predikoi ai	20:91
<b>Haruti e Maruti:</b> gjithë ngjarja e tyre dhe ndreqja e keqinterpretimeve	2:103
<b>Haxherja:</b> gruaja e Ibrahimit <sup>as</sup>	14:38; 37:103; 2:130, 143, 159
<b>Haxhi:</b> pelegrinazhi në Mekë	2:197
domethënie e haxhit, e <i>tavafit</i> , e gurit të zi	3:98
është obligim për atë që ka mundësi ta bëjë	3:98
bëhet në muajt e caktuar	2:198
shpallja rreth tij	22:28; 9:3



» <b>Haxhi:</b> ndalimet në të	5:2-3; 5:96-97
ritet e tij	2:159; 2:197-201, 204; 22:29-30
haxhi i madh	9:3
<b>Hekuri:</b>	57:26; 17:51; 18:97; 22:22; 34:11; 40:72; 76:5
<b>Hëna:</b>	2:190; 6:78, 97; 7:55, 131; 10:6; 12:5; 13:3; 14:34; 16:13; 21:34; 22:19; 25:62; 29:62; 31:30; 35:14; 36:40-41; 39:6; 41:38; 55:6; 71:17; 84:19; 91:3
eklipsi i saj	75:9-10; 81:2
ndarja e saj në dy pjesë	54:2; 7:108
i bën sexhde Allahut	22:19
dielli e hëna janë ndër shenjat e Allahut	41:38
zmadhimi dhe zvogëlimi i saj	36:40
mjet për të llogaritur kohën	2:190; 6:97; 55:6
eklipsi i diellit dhe i hënës në epokën e fundit	75:10
dielli ka dritën e vet, kurse hëna e ka të huazuar	10:6
hëna e dielli nuk mund të përplasen me njëra-tjetrën	36:41
<b>Hidja:</b> hidja e tejskajshme ( <i>sidretul-munteha</i> )	53:14-18; 53:17
hide	34:17; 56:29
<b>Hipokritët:</b>	63:2-9; 2:9-21, 205-207; 4:64, 89, 139, 141, 143; 9:54, 64-69, 80, 84, 107-108; 33:2, 49; 37:8; 47:24; 57:14-16; 59:12-18
që tremben me “shi”, “bubullimë” a “vetëtimë”; domethënie	2:20-21
shmangeshin të luftonin në kohë lufte	9:45-59; 3:155, 168; 48:16; 33:14
dëshirat e tyre	48:13
do të jenë në thellësinë më të madhe të xhehenemit	4:146
<b>Hixhabi:</b> shamia	24:31-32; 24:59, 61; 33:33-34, 60
ulja e shikimit edhe për burrat, edhe për gratë	24:31-32
hixhabi me <i>xhilbab</i> (mbulesat)	33:60
<i>khumuri</i> (shamia e kokës deri nëpër kraharorë)	24:32
lehtësi në hixhab për gratë e moshuara	24:61
porosia për të mos ekspozuar bukurinë e trupit përpara burrave të huaj	24:32

<b>Hixhreti:</b> emigrimi	16:42-43
i Ademit	20:124; 2:37; 7:25
i Ibrahimit dhe i Lutit	21:72; 19:49; 29:27
i Ejubit	38:42
i Profetit Muhammed	28:86; 8:31; 9:40; 17:81; 17:2; 89:2-6
i besimtarëve	4:98-101; 2:219; 3:196; 4:90; 8:73; 9:20; 16:111; 22:59; 29:27
<b>Homoseksualiteti:</b>	26:166-167; 7:81-82; 11:80; 27:55-56
<b>Hudejbija:</b> marrëveshja e Hudejbijes	48:2, 11, 19-21
<b>Hudi</b> <sup>as</sup> : Profet për popullin ad populli i tij u ndëshkua	7:66; 7:67-68; 11:51; 26:124-126; 46:22-24 69:7-8; 7:73; 11:60; 41:14; 46:25-26; 51:42- 43; 54:20-21
<b>Humbësit:</b>	2:122; 2:28, 65; 3:86, 150; 4:120; 5:6, 22, 31, 54; 6:32, 141; 7:24, 91, 93, 100, 150, 179; 8:38; 9:69; 10:46, 96; 11:23, 48; 12:15; 16:110; 18:104; 21:71; 22:12; 27:6; 29:53; 39:16, 64, 66; 40:79, 86; 41:24, 26; 42:46; 45:28; 46:19; 58:20; 63:10
<b>Hyritë:</b>	37:49-50; 38:53; 55:73-75; 44:55; 52:21; 56:23-27, 56:36-38; Shih edhe: <b>Xheneti</b>
<b>Iblisi:</b> djalli	2:35; 7:12-13; 15:29-43; 26:96; 30:13, 50; 34:21 Shih edhe: <b>Shejtani</b>
i përzënë	7:14; 7:19; 15:35; 17:64; 38:78
armiku i Ademit	20:118; 7:14
prej xhindëve	18:51; 15:28
nuk ishte prej engjëjve	2:35
natyrë zjarri	55:16; 7:13; 15:28; 38:77
refuzoi të nënshtrohej	7:12; 2:35; 15:32, 34; 17:62; 18:51; 20:117; 38:75-76
<b>Ibrahimi</b> <sup>as</sup> : i zgjedhur, njeri me duar të fuqishme dhe largpamës	38:46-8
debatoi me popullin e tij	6:77-84; 19:42-49; 26:70-83
babai i tij, Azeri	6:75
betimi i Allahut për të dhe për djalën e tij	90:4
Zoti i dhuroi Is'hakun e Jakubin	6:85; 14:40; 19:50; 21:73; 29:28
Zoti i dhuroi Ismailin	14:40
shkatërroi idhujt	21:58-9; 37:94
sfidoi mbretin Nemrud	2:259
mrekullia e zjarrit, që iu bë i ftohtë	21:69-71; 29:25; 37:98-99
i vijnë miq ose të dërguarit e Zotit	11:70-77; 15:52-53; 51:25-26

» <b>Ibrahimi</b> <sup>as</sup> : u urdhërua të njoftonte për pelegrinazhin e Haxhit	22:28
neveri ndaj djallit dhe idhujve	19:45; 21:53; 37:87; 43:27-28
mërgimi drejt Zotit	29:27; 19:49; 21:72
distancimi nga armiqtë e Allahut	9:114; 60:5-6
nuk gënjeu	19:42; 21:64; 37:90
shikonte në ëndërr duke therur djalin e tij, Ismailin; argumentet që ai Ismailin do ta flijonte, e jo Is'hakun	37:103
porositi pasardhësit t'i nënshtroreshin plotësisht Zotit	2:133; 43:29
u porositi për ta pastruar Shtëpinë e Allahut	22:27; 2:126
gjiithmonë i anuar ndaj Allahut	2:136; 3:68, 96; 4:126; 6:80, 162; 16:121, 124
Allahu zgjodhi pasardhësit e tij	3:34
dënon zotat e rremë dhe besimet e popullit të tij	19:43; 6:75; 21:53-55; 26:73-75; 37:86-87
besimtar i palëkundur në Njëshmërinë e Zotit	43:27-29
mik i Zotit	4:126
përbushi urdhëresat Hyjnore	53:38
sihariqi për lindjen e Is'hakut dhe të Jakubit	11:72; 15:54-56; 37:113; 51:29
sihariqi për lindjen e Ismailit	37:102
kujtimi i mirë të mëvonshmit	37:109
i udhëzuar dhe i zgjedhur	2:131; 2:125; 16:122; 21:52, 74; 29:28; 38:46-48
mikpritja e tij	11:70; 51:25-28
u caktua Imam	2:125; 2:131; 16:122
në qëndrimin e tij gjejeni vendin e faljes	2:126; 3:98
as hebre (jehudi), as i krishterë	2:141; 3:66, 68
lutjet e tij për popullin e Lutit	11:75
lutjet e tij për faljen e babait	9:114; 19:48; 26:87; 60:5
lutjet e tij për një djalë	37:101-102; 2:129
lutjet e tij për sigurinë dhe prosperitetin e Mekës	14:36; 2:127; 14:38
lutjet e tij për vete dhe për pasardhësit e tij	2:129; 2:125; 37:101
lutjet e tij	14:36-42; 2:127-130; 26:86-88; 37:101; 60:5-6
lutjet për një të Dërguar	2:130

» <b>Ibrahimi</b> <sup>as</sup> : pasardhësit iu bekuan me Librin, urtësinë, sundimin, shpalljen, profetërinë, udhëheqjen	4:55; 21:74; 29:28; 37:114; 38:46-48; 57:27
rindërtimi i Qabesë me Ismailin	2:128
refuzoi trupat qiellorë si zota	6:77-79
katër zogjtë e Ibrahimit; Zoti i tregoi si i ringjall të vdekurit	2:261
feja e tij	2:131; 2:136; 3:96; 4:126; 6:162; 12:39; 16:124; 22:79
debatoi me popullin e tij dhe e turpëroi	21:58-68; 29:17-18
historia e tij	19:42-51; 6:75-85; 11:70-77; 14:36-42; 15:52-61; 21:52-74; 22:27-28; 29:17-28; 37:84-114; 51:25-35
Zoti ia tregoi mbretërinë e qiejve dhe të tokës	6:76
vendosi Ismailin dhe Haxheren pranë Shtëpisë së Shenjtë	14:38
skriptet e tij	87:20; 53:37-38
nënshtrimi ndaj Zotit të botëve	2:132
njeri i vërtetë dhe Profet	19:42
shumë i dhembshur, durimtar	9:114; 11:76
u sprovua prej Zotit të tij	2:125; 37:107
ishte prej grupit të Nuhut	37:84
<b>Idrisi</b> <sup>as</sup> : Enoku	19:57-58; 21:86-87
<b>idhujtaria</b> :	4:49; 4:117; 30:36
<b>Ifriti</b> :	27:40
<b>Ihrami</b> :	5:2; 5:96-97
<b>Iljasi</b> <sup>as</sup> : Elija	37:124-133; 6:86; 38:49
<b>Il-lijun</b> :	83:19-21
<b>Imami</b> : imam	2:125; 11:18; 15:80; 17:72; 21:74; 25:75; 36:13
<b>Imam Mehdiu</b> :	Shih: <b>Mesihu i Premtuar</b>
<b>Imrani</b> :	3:34; 3:36; 66:13
<b>inshaAllah</b> :	68:19; 18:24-25; 68:18-20; 37:103; 2:71; 48:28; 12:100; 18:70; 28:28
<b>Intriga</b> : komplete	3:55; 4:109; 6:124; 7:100, 124; 8:31; 10:22; 12:6; 13:34, 43; 14:47; 16:27, 46; 27:51-52; 34:34; 35:11, 44; 40:46; 52:43; 71:23
<b>Isai</b> <sup>as</sup> : lindja e tij	19:17-29; 3:46, 48, 60; 4:157
pse lindi pa baba?	3:48
krahasimi i tij me Ademin	3:60

» <b>Isai</b> <sup>as</sup> : Zoti e zgjodhi dhe e nderoi	3:46; 2:88, 254; 4:172; 5:111; 6:86; 19:31-32; 21:92; 23:51
misioni i tij	61:7; 3:50-51; 5:73; 23:51; 43:60, 64
i Dërguar vetëm për Bijtë e Izraelit	3:50
mrekullitë e tij	3:50; 3:47; 5:111; 21:96; 19:30-34; 13:20
persekutimi i tij	2:88; 4:158-159
i mallkoi mohuesit prej bijve të Izraelit	5:79
katër premtime që Allahu i bëri atij	3:56
nuk vdiq në kryq	4:158-159; 5:111; 3:55
kuptimi i fjalës <i>salebe</i> ; kryqëzimi ishte dënim me vdekje në një mënyrë poshtëruese	4:158
ngritja e tij drejt Allahut, jo në qiellin fizik	4:149; 17:94
shembuj të udhëtimit drejt Allahut	51:51; 7:176-177; 19:57-58; 89:29-31; 38:51
provat nga Bibla se Jezusi u zbrit i gjallë nga kryqi	4:159
udhëtoi drejt Kashmirit të Indisë; hixhreti i tij	23:51
vdekja e Isait <sup>as</sup> ; pati vdekje natyrale; argumente për vdekjen e tij	5:116-118; 3:56; 3:145; 21:9; 16:22; 21:35
fjala <i>teveffa</i> do të thotë vdekje: shembuj nga Kurani	2:235; 2:241; 3:56; 3:194; 4:16; 4:98; 5:118; 6:61; 6:62; 7:38; 7:127; 8:51; 10:47; 10:105; 12:102; 13:41; 16:29; 16:33; 16:71; 22:6; 32:12; 39:43; 40:68; 40:78; 47:28
zbritja e tij nuk do të zbritje fizike	39:7; 2:56; 3:40; 65:11-12
nuk ishte as i biri i Zotit, as Zoti, as njëri prej tre zotave	3:3; 3:7, 46, 60; 4:172-173; 5:18, 73-74, 76-77, 117; 9:30; 17:112; 19:31, 36, 91-93; 21:22; 23:92; 39:5; 43:16, 82; 77:31; 82:2, 6-7
ishte fjala e Zotit; kuptimi	3:46
zbritja e tij; premtimi për rikthimin e tij;	Shih: <b>Mesihu i Premtuar</b>
<b>Is'haku</b> <sup>as</sup> :	19:50-51; 2:134, 137; 4:164; 6:85; 11:72; 14:40; 15:54; 21:73-74; 29:28; 37:113-114; 38:46; 51:29
<b>Islami</b> : islam do të thotë nënshtrim dhe paqe	3:20; 6:20
ç'është Islami?	6:20; 2:113; 6:163-164
vazhdimi i mësimave të mëparshme	42:14-16
feja e përkryer dhe përfundimtare	5:4, 22:79; 14:25-26; 42:41
feja mbarëkombëtare	7:159; 6:20; 34:29; 1:2
efektet e tij në jetën e besimtarit	14:25-26
shtyllat e besimit	2:286; 2:5

» <b>Islami:</b> heq dallimet racore	49:14
vendos paqen ndërftare	40:79; 35:25; 10:48; 60:9
pranimi i veprave vetëm përmes Islamit	3:86
harmonia ndërftare	40:79; 3:65; 2:115; 6:109
nuk ka imponim në të	2:257; 7:89; 10:100; 11:29; 18:30
nuk ka ngarkesa përtej kapacitetit	2:287; 2:186; 5:7; 22:79
Islami të largon frikën dhe brengën	2:113
feja që është në natyrën e njeriut	30:31; 39:24
është feja e vërtetë	3:19-21; 4:126
është fe e baraspeshuar	2:144
fe që synon lehtësi	2:186; 5:7; 22:79
është rruga e drejtë për ta arritur Zotin	6:154; 1:6
atij që Allahu do që ta udhëzojë, ia hap zemrën për Islamin	6:126
po e gjete Islamin, gjete udhëzimin	3:21; 72:15
ai që pranon Islamin, ka kapur lidhjen më të fortë	31:23
Islami të jep dritë	39:23
ai që pranon Islamin, nuk i ka bërë nder Allahut, por Allahu atij	49:18; 3:165
“mos vdisni kurrsesi, përveçse muslimanë”; kuptimi	2:133; 3:103
premtimi i Allahut për Kalifatin në Islam	24:56
<i>shura</i> : sistemi i këshillimit në Islam	42:39; 3:160
muslimanët duhet të bashkëpunojnë në mirësi e <i>takva</i>	5:3
të mëson të bësh drejtësi edhe me armikun	5:9
drejtësi edhe me ithtarët e feve të tjera	6:109
bashkëjetesë me çdo jomusliman paqedashës	60:9
kategorikisht hedh poshtë idenë e luftërave të dhunshme	60:9
Vetë Allahu e ka zgjedhur emrin <i>islam</i> dhe <i>muslim</i> (musliman)	5:4; 22:79
mos i thuaj <i>qafir</i> atij që të përshëndet me <i>selam</i>	4:95
ata që e kërkojnë Zotin me sinqeritet, cilëso bindjeje t'i përkasin, Zoti i udhëzon në rrugë të drejtë	f. 667

nëse idhujtari ju kërkon strehë, strehojeni	9:6
mësimi i Islamit për të vendosur paqe, kur dy shtete luftojnë me njëra-tjetrën	f. 911
merrni masat për shpëtimin tuaj	4:72
mos i bëni shokë mohuesit, duke i lënë besimtarët	4:145
mos qëndroni me ata që tallen me ajetet ose shenjat e Allahut	4:141; 6:69
ushqimi juaj të jetë jo vetëm hallall, por edhe i pastër ( <i>tajjib</i> )	2:169; 5:89
kur mund t'u lejohen muslimanëve plaçkat e luftës?	8:68; 8:70
mos bëni pyetje të padenja	5:102
triumfi mbarëkombëtar i Islamit	61:10; 9:33; 13:42; 48:29
ata që do të ndezin luftëra kundër Islamit, do të shkatërrohen	f. 1186
ata që do të tentojnë të shkatërrojnë Mekën ose Islamin, do ta pësojnë si <i>njerëzit e elefantit</i>	f. 1174
Islami do të vijojë të përparojë, armiku do të vijojë të mbetet ziliqar	f. 1190
Përparimi i Islamit në të ardhmen është i pandalshëm	f. 1184
profecia që dielli i Islamit do të lindë sërish	f. 1140
përshkrimi i sakrificëbërësve të periudhës së parë dhe të dytë të Islamit	f. 965
<b>Ismaili<sup>as</sup>:</b>	14:38-40; 2:126, 128, 137; 3:85; 4:164; 6:87; 19:55-56; 21:86; 37:101-108, 114; 38:49
djali që do të flijohej nga Ibrahim	37:103
<b>Isra:</b> udhëtim shpirtëror gjatë natës	17:2; 17:61; Shih edhe: <b>Miraxh</b>
<b>Istigfari:</b> t'i kërkosh falje Zotit	73:21
istigfari kur bën gjynah	3:136
ata që kanë druajtje, bëjnë istigfarin vazhdimisht	51:19
engjëjt bëjnë istigfar për besimtarët	42:6; 40:8
porosia për Profetin që të bëjë istigfar për besimtarët	3:160
istigfari sjell bekimet e Zotit	11:4, 53; 71:11-13
nëse bën istigfarin, do ta gjesh Allahun Falës, Mëshirëbërës	4:65, 111

» <b>Istigfari:</b> Allahu nuk i ndëshkon ata që bëjnë istigfar	8:34
ndalimi për të bërë istigfar për idhujtarë të përbetuar	9:113
istigfari i Ibrahimit për babain e tij për shkak të një premtimi	19:48; 9:114
istigfari i Profetit për hipokritët nuk u sjell dot dobi	9:80
çfarë nënkupton istigfari i Profetit?	48:3
<b>Ithtarët e Librit:</b> çfarë do të thotë ithtarët e Librit?	3:65 Shih edhe: <b>Bijtë e Izraelit</b>
ithtarët e Librit	4:160; 2:106, 110; 3:21, 65-66, 70, 72-73, 76, 99-100, 111, 114, 200; 4:48, 124, 154, 172; 5:6, 16, 20, 60, 66, 69, 78; 9:29; 29:47; 33:27; 42:15; 45:17; 57:30; 59:3; 98:2, 7 Shih edhe: <b>Bijtë e Izraelit</b>
<b>Jahja</b> <sup>as</sup> : Gjon Pagëzori	3:39-40; 19:8, 13-16; 21:91
<b>Jakubi</b> <sup>as</sup> : Izraeli	2:137; 2:133, 134, 141; 4:164; 12:7; 19:50-51; 21:73-74; 38:46
emri i tij edhe Izrael	3:94; 19:59
bjtë e tij	2:137; 12:59-101
porosia e tij në momentet e vdekjes	2:134
<b>Jerusalemi:</b>	2:260; 17:2, 6; 21:86
Bejtul Makdisi, kibleja e parë e muslimanëve	2:143; 2:148
<b>Jeta:</b> është përpjekje	90:5; 6:32; 84:7; 53:40; 30:54
jeta e pastër	16:98
krijimi i saj	36:37; 18:38, 46; 21:31; 23:13-15; 40:68; 51:50; 67:31; 71:15; Shih edhe: <b>Njeriu</b>
jeta e vërtetë është jeta e <i>ahiretit</i>	29:65
e përtejme	87:17-18; 3:16; 4:78; 9:38
e kësaj bote	23:113-115; 2:87, 201, 213; 3:15, 186; 4:75, 95; 6:30, 33, 71, 131; 7:52; 9:38; 10:8-9, 25, 65; 11:16; 13:27; 14:4; 16:108; 17:19; 18:29, 46-47, 104-105; 20:132; 23:38; 28:61; 29:64, 65; 30:8; 31:34; 35:6; 40:40; 41:32; 42:37; 43:36; 45:25, 36; 46:36; 47:27; 53:30; 57:21; 76:28; 79:39; 87:17-18
qëllimi i saj	23:116; 6:32; 16:98; 30:9; 51:57; 67:3
jeta e kësaj bote është përfitim i shkurtër, lojë, dëfrim, zbukurim,	57:21; 18:47; 28: 61-62; 47:37, 6:33; 2:213; 18:29; 20:98; 29:65; 33:29



» <b>Jeta:</b> jeta e kësaj bote është mashtrim	3:186; 6:71; 6:131; 7:52; 31:34; 35:6; 45:36; 57:21
jeta e kësaj bote është përfitim i shkurtër	57:21; 40:40; 3:15; 4:95; 9:39; 10:24; 11:16; 42:37; 43:36
ata që e lakmojnë shumë jetën e kësaj bote	2:97
<b>Jetimët:</b> drejtësia me ta	4:128; 4:4
pasuria e tyre	4:3; 4:7, 11; 6:153; 17:35
trajtimi i tyre	2:84; 2:221; 4:9; 4:37, 128; 89:18; 93:10; 107:3
mirëqenia e tyre	2:221; 2:178, 216; 4:3-4, 128; 8:42; 59:8; 76:9; 90:15-16
jetimin mos e shtyp	93:10
në mënyrë të veçantë kujdesu për jetimët në fis	90:15-16
martesa me vajzat jetime	4:4
porosia për mbrojtjen e të drejtave dhe të pasurisë së jetimëve	4:3-7
<b>Jexhuxhët e Mexhuxhët:</b>	18:93-101; 21:97 Shih edhe: <b>Mesihu i Premtuar</b>
<b>Junusi</b> <sup>as</sup> : Jona	10:99; 37:140-149; 4:164; 6:87-88; 21:88; 68:49-51
<b>Jusufi</b> <sup>as</sup> : Jozefi, ai dhe Benjamini	12:5-103
Jusufi dhe gruaja e Potifarit	12:24-36; 12:51-54
vëllezërit e tij	2:137; 12:59-100; 12:81
ëndrrat dhe shpjegimi i tyre	12:5-7; 12:22; 12:37-38; 12:44-50; 12:101
lutjet e tij	12:102
mbreti e zgjedh për vete	12:55-57
<b>Kafshët:</b> ( <i>dabbeh</i> )	2:165; 6:39; 11:7, 57; 16:50, 62; 24:46; 27:83; 29:61; 34:15; 35:46; 42:30; 45:5
bleta	16:69
balena	21:88
brekosa	7:134
bagëti	3:15; 4:120; 5:1, 96; 6: 137, 139, 143; 7:180; 10:25; 16:6, 67, 81; 20:55; 22:29, 31, 35; 23:22; 25:46, 50; 26:134; 32:28; 35:29, 36:72; 39:7; 40:80; 42:12; 43:13; 47:12; 79:34; 80:33
delja	6:137; 20:19; 21:79; 38:24-25
derri	2:174; 5:4, 61; 6:146; 16:116
deveja	7:41; 77:34; 7:74, 78; 11:65; 17:60; 26:156; 54:28; 91:14; 12:66, 73; 6:145; 88:18; 81:5; 56:56

» <b>Kafshët:</b> dhia	6:144
elefanti	105:2
miza	22:74
gjarpri	7:108; 26:33; 27:11; 28:32; 20:21
kali	3:15; 8:60; 16:9; 17:65; 59:7; 38:32
karkaleci	7:134; 54:8
lopa	2:68-72; 6:145, 147; 12:44, 47
luani	74:52
majmuni	2:66; 5:61; 7:167
merimanga	29:42
morri	7:134
mushka	16:9
mushkonja	2:27
njëthundrak	6:147
peshku	7:164; 18:62, 64; 37:143; 68:49
qeni	7:177; 18:18, 23
sorra	5:32
tenja ose kandrra	101:5
thëllëza	2:58; 7:161; 20:81
ujku	12:14-15, 18
viçi	2:52, 55, 93-94; 4:154; 7:149, 153; 11:70; 20:89; 51:27
zogu	2:261; 3:50; 5:111; 12:37, 42; 16:80; 21:80; 22:32; 24:42; 27:17-18, 20; 34:11; 38:20; 67:20; 105:4
gomari	2:260; 16:9; 31:20; 62:6; 74:51
Allahu i ushqen dhe kujdeset për to	11:7; 29:61
për dobinë e njeriut	23:22; 6:143; 16:6-9, 67, 70, 81; 22:34; 31:11; 36:73-74; 40:80; 43:13; 55:11
janë krijuar në çifte	51:50; 6:144-145; 36:37; 39:7; 43:13
lloje të ndryshme	24:46
të lejuara për t'u ngrënë	5:2; 5:97, 104; 6:120; 16:15; 35:13
kurban	22:35; 5:98; 22:37
si shembuj	2:172; 2:66; 5:61; 7:167, 177, 180; 25:45; 29:42; 62:6
të ndaluara për t'u ngrënë	5:4; 2:174; 5:2, 96; 6:146

» <b>Kafshët:</b> <i>neml</i> nuk është milingona por emri i një populli	27:19
<i>hud-hud</i> nuk është një pupëz a zog, por një gjeneral i ushtrisë së Sulejmanit	27:21
<b>Kalendari:</b>	9:36; 2:190, 198; 6:97; 10:6; 17:13; 31:30
<b>Kalifi /Kalifati:</b> <i>khalife / khilafe</i>	2:31; 38:27; 7:70; 7:75; 27:63
Kalifi i Allahut është Profeti i Tij	2:31
premtimi i Allahut për vendosjen e kalifatit për besimtarët; kalifati vjen prej Zotit me plotësimin e disa kushteve	24:56
kalifi këshillohet me të tjerët	42:39; 3:160
zëvendës i Profetit	7:151; 7:143
popull mëkëmbës	6:166; 10:15; 10:74; 35:40; 57:8; 6:134; 11:58
<b>Kamata:</b> fajdeja, interesi	Shih: <b>Ekonomia</b>
<b>Kamfuri:</b> pije, e përzier me kamfur	76:6
<b>Keruni:</b>	28:77; 28:80, 82-83; 29:40-41; 40:25
<b>Katastrofat:</b> ligji i Zotit për to	6:132; 7:95; 11:118; 16:46-47; 17:16; 20:135; 26:209; 28:60; 38:4; 67:17-20
krisma	11:68; 2:56; 4:154; 13:14; 41:14, 18; 51:45
përmytjet	21:77-78; 7:65, 137; 10:74; 20:79; 26:121, 174; 27:59; 37:83; 54:12-13; 71:26
i shpëton besimtarët	11:59; 7:73; 11:67, 95, 118;
furtuna	54:20-22; 7:134; 15:74-75; 26:174; 46:25-26; 51:34, 42-43; 54:20-21, 32, 35; 68:20; 69:6-8
tërmetet	11:68; 7:79, 85, 92; 11:83; 15:84; 29:38
ndëshkimi për shkak të refuzimit të shenjave	38:15-16; 3:113; 34:46
thatësira	7:131
ndëshkimi	23:77-78; 7:138; 11:95; 21:47; 26:159; 41:14;
<b>Keutheri:</b>	108:2
<b>Kisha:</b> mbrojtja e tyre	22:41
<b>Kombet:</b>	11:102; 2:245, 262, 270; 3:27-28, 140; 7:35; 10:25; 17:17; 21:97, 105; 23:81; 29:21, 25; 31:30; 35:10; 36:69; 38:54; 83:2-6; 90:14-18; 103:2-4; 111:5-6
<b>Komunikimi me Zotin:</b> Llojet e komunikimit me Zotin	42:52 Shih edhe: <b>Shpallja</b> Shih edhe: <b>Ëndrra</b>
vijon edhe sot dhe do të vijojë përherë	28:8; 41:31-32
<i>keshfi</i> (vizioni)	12:95

» <b>Komunikimi me Zotin:</b> vizioni/ ëndrra e Ibrahimit	37:103; 2:261
vizioni/ëndrra e Ezekielit	2:260
vizioni/ëndrra e Profetit Muhammed	48:28; 8:44; 17:2, 61; 38:46; 48:2, 28; 53:14; 54:2
vizioni/ëndrra e Jusufit <sup>as</sup>	12:5; 12:101
vizioni i nënës së Merjemes	3:37
vizioni i Merjemes <sup>as</sup>	3:48; 19:18-19, 22
vizioni i Musait <sup>as</sup>	18:61-66; 7:108; 18:72; 20:11; 27:8
<b>Kontrata:</b>	2:283-284; 5:2
<b>Kotësia:</b> gjëra të kota	5:90; 2:226; 19:63; 23:4; 25:73; 28:56; 41:27; 52:24; 56:26; 78:36; 88:12
<b>Krishterimi:</b> të krishterët	2:63; 2:112-13, 121, 136, 141; 3:68; 5:15, 19, 52, 70, 83; 9:30, 32; 18:9-44; 20:106; 22:18; 22:41; 61:15
të krishterët e sinqertë që përloren dhe luten duke e njohur të vërtetën	5:84
<b>Kryqëzimi:</b> gozhdimi	7:125; 5:34; 12:42; 20:72; 26:50
kryqëzimi i Jezusit:	Shih: <b>Isai</b> <sup>as</sup>
<b>Kurani:</b>	Shih edhe: <b>Shkurtesat, Lutjet e Kuranit, Profecitë e Kuranit, Shfuqizimi</b>
engjëjt dëshmojnë zbritjen e tij	4:167
renditja e tij	17:107
katër kritere të përsosmërisë	2:6
disa arsye bindëse se Kurani është Fjala e Zotit	10:38
dhe skriptet e mëparshme	2:36; 2:42, 90, 92, 98, 102, 244; 3:4, 82; 4:48; 5:49; 6:115; 10:38; 12:112; 18:3; 26:193- 198; 35:32; 46:13, 31
dhe dija	17:87; 2:186; 3:8; 4:167; 7:53; 15:22; 17:108
karakteristikat e tij	87:9; 10:58; 12:2-3; 15:22; 17:90; 18:2-3; 21:25; 26:3; 29:50; 43:45; 54:18; 56:80; 80:14-17; 98:4
mbledhja, mbrojtja e tij	15:10; 75:17-18; 4:83; 5:49; 15:2, 18-19; 26:194, 211-213; 27:2; 37:11; 56:78-79; 85:22- 23; 87:7-9
kuptueshmëria	54:18; 19:98; 39:28; 44:59; 54:23, 33, 41
nuk ka kundërthënie në të	4:83
nuk ka dyshim në të	2:3
shumëkuptimësia në fjalët e tij	39:24
po ta tërhiqte Allahu, nuk do ta gjeje më	17:87

» <b>Kurani:</b> ama e Librit	3:8
ajetet e vendosura dhe ato të figurshme	3:8
shpjegime të përsëritura	55:17; 17:90; 18:55; 20:114; 25:51; 30:59; 39:28; 17:42; 46:28
është nga Allahu	2:2; 4:114; 2:24, 90, 232; 4:137, 141, 175; 7:197; 10:38; 12:4; 14:2; 16:45, 90; 17:71; 20:3, 5; 25:2, 5-7, 34; 26:193, 212-214; 27:7; 29:48; 32:3-4; 39:2; 42:8, 30, 33; 44:4; 45:3; 46:3; 53:5-6; 56:78-81; 57:10; 69:39-53; 76:24;98:3
shërim e udhëzim	10:58; 2:3, 186; 6:156; 7:3, 53, 57; 12:112; 16:103; 17:42, 83; 27:3; 39:24, 42; 42:18, 53; 45:21; 50:46; Shih edhe: <b>Spiritualizmi</b>
është kujtesë, libër që gjendet në ndërgjegjen e njeriut	11:121; 38:2
kundërshtimet ndaj tij	25:33-34; 3:8; 4:83; 6:26; 8:32; 10:40; 11:2; 16:25, 104; 17:94; 18:110; 21:3-6; 23:84; 25:5- 6; 27:7, 69; 34:44; 41:27; 43:31-32;46:8, 18; 52:34; 68:16; 74:25; 83:14;87:6
shtatë ajete që përsëriten; shtatëvargëshi i përsëritur	15:88; 1:6
kërko mbrojtjen e Allahut përpara se ta lexosh	16:99
dëgjo Kuranin me vëmendje	7:205
recitimi i tij në mëngjes ka vlerë të madhe	17:79
e kuptojnë vetëm ata që Allahu i cilësoi si të pastër; komentim i Kuranit	56:80
krahasimi i Kuranit me universin	56:76-80
mësimet e mëparshme	3:4; 5:49; 6:92; 18:83; 80:14; 98:4
asnjë ajet i tij nuk është i shfuqizuar	2:107; 16:102
Zoti e zbriti atë pjesë-pjesë; arsyjeja	25:33
recitimi i tij	7:205; 16:99-101; 17:46, 79, 107; 18:28; 27:93; 29:46; 43:4; 73:5, 21; 96:4
shpallja e tij	2:186; 12:3; 13:38; 16:104; 17:107; 20:5, 114; 25:33-34; 26:194-197; 39:29; 41:4; 42:8; 43:4; 44:4-5; 46:13; 76:24; 97:2
shenjë mëshire	29:52
elokuenca e tij	12:3; 13:38
kuptimi i vërtetë i tij	56:78-81; 3:8-9
të vërteta, fakte shkencore dhe historike	51:8-9; 10:93; 13:4; 16:14, 16-17, 79, 85; 20:54; 21:31-32; 24:25; 41:43; 42:30 Shih edhe: <b>Universi, Njeriu, Toka, Jeta, Shkenca, Ekonomia, Profetët</b>

universaliteti i tij	25:2; 2:22; 26:193; 34:29;38:30; 81:28
profecia që në një kohë, muslimanët do ta braktisnin Kuranin	25:31; 45:7
ajetet ku lexuesi të bëjë sexhde	Shih: <b>Sexhdeja</b>
në pllakën e ruajtur	85:22-23
sfida për të sjellë të ngjashmin e tij	2:24; 11:14; 10:39; 17:89
<b>Kurbani:</b> i Ismailit	37:103
i bijve të Ademit	5:28
i pasurisë	47:37-39; 2:216; 57:12, 19; 61:12; 63:10-11
praktikë universale	22:35;
i kafshëve	22:37-38; 5:3
kurbani të cilin e ha zjarri	3:184
<b>Lapsi:</b>	96:5-6; 3:45; 31:28; 68:2
<b>Leje:</b> nga Allahu	64:12; 2:98, 103, 214, 222, 250, 252, 256; 3:50, 146, 153, 167; 4:65; 5:17, 111; 7:59; 8:67; 10:4, 101; 11:106; 13:39; 14:2, 12, 24, 26; 22:66; 33:47; 34:13; 35:33; 42:52; 58:11; 59:6; 97:5
për të luftuar (për vetëmbrojtje)	22:40-41
<b>Letrat:</b>	6:92; 6:8; 21:105
<b>Libri:</b>	Shih edhe: <b>Kurani</b>
i veprave	17:14; 7:38; 17:72; 18:50; 23:63; 39:70; 45:29-30; 69:20, 26; 83:8, 10, 19, 21;
që ruan çdo gjë ( <i>kitabun hafidh</i> )	50:5
i fshehtë ( <i>kitabum meknun</i> )	56:79
i shkruar	52:3; 17:59
i qartë	34:4; 6:60; 10:62; 11:7; 27:76
thesari i njohurive rreth Zotit	10:62; 2:3; 3:4; 4:106; 5:49; 6:39, 60, 93; 7:3; 11:7; 22:71; 27:76; 34:4; 50:5
shënuesi i veprave dhe i mendimeve të njeriut	9:120-121; 3:54, 182; 4:82; 5:84; 10:22; 19:80; 21:95; 43:20, 81; 54:53; 82:12
thesari i ligjeve dhe i dekreteve Hyjnore	57:23; 2:136; 4:25; 8:69, 76; 9:36; 13:39; 15:5; 17:59; 30:57; 33:7; 35:12
shpalljet që iu dërguan të Dërguarve	5:49; 2:54, 214; 3:49, 82; 4:163; 6:92; 11:18; 13:2; 19:31; 20:134; 23:50; 25:36; 28:44; 32:24; 35:26; 37:118; 40:54, 71; 41:46; 46:13; 57:26
dokument	24:34; 27:29-30
<b>Lindja e Perëndimi:</b>	73:10; 2:116, 143, 178, 259; 7:138; 19:17; 24:36; 26:29; 37:6; 43:39

<b>Lojërat:</b> lojë, argëtim, sport	5:58-59; 6:33, 71; 7:52, 99; 12:13; 21:3, 17; 29:65; 43:84; 44:10, 39; 47:37; 52:13; 57:21; 62:12;70:43
<b>Lufta:</b> <i>kital</i>	Shih edhe: <b>Xhihadi</b>
mbështetja e Allahut	4:85; 8:43-45; 2:252; 3:14; 9:14, 29; 22:39
kushtet për të	2:191-192; 2:194, 218; 4:76, 91; 5:34; 8:40, 46-47, 59, 61-62, 68-72; 9:5-8, 36; 16:127; 22:40-42, 61; 47:5, 36; 59:6
për hir të Allahut	2:245; 2:247; 4:61, 75-77; 8:66; 9:36, 38, 111, 123; 73:21
ata që bien në të (dëshmorët)	9:52; 2:155; 3:158, 170; 4:75
të burgosurit e saj	8:71-72; 2:86; 4:4, 25; 8:68; 9:6; 60:12; 76:9
ndëshkimi i atyre që shkaktojnë trazira	5:34-35
frika ndaj saj	2:217; 4:78; 5:34; 8:58; 47:23
plaçkat e saj	59:7-11; 8:2, 42, 70; 33:51; 3:162; 48:16; 60:12
për t'u dhënë fund trazirave dhe për të vendosur paqen	49:10; 2:192, 194, 218; 4:91; 8:40; 9:6, 12, 30
<b>Lukmani</b> <sup>as</sup> :	31:13-21
<b>Lumi:</b>	2:250, 267; 16:47; 17:92; 18:34
lumenj që rrjedhin	2:26; 3:16; 13:36; 85:12; 98:9
<b>Luti</b> <sup>as</sup> : Profet i Zotit	27:55; 6:87; 21:75; 26:163; 37:134
historia e tij	11:78-84; 7:81-85;15:62-78; 21:72; 26:161-175; 27:55-59; 29:27; 37:134-139; 54:34-40
ligësitë e popullit të tij	27:55-56; 7:81-82; 26:161, 166-167; 27:57; 29:29-30; 38:13; 54:34
gruaja e tij	66:11; 15:61; 27:58
populli i tij u shkatërrua	7:85; 11:83;15:75; 26:173-174; 27:59; 37:137; 51:34; 54:35, 37-39
<b>Lutja:</b> lutja ose duaaja është nevojë jetike	25:78; Shih edhe: <b>Lutjet e Kuranit</b>
“Lutmuni Mua, Unë do t’ju përgjigjem”	40:61
“I përgjigjem lutjes së lutësit, kur ai Më lutet”	2:187
“kush është ai që i përgjigjet lutjes së hallexhiut...?!”	27:63
pse disa lutje pranohen e disa jo?	2:156; 34:53
kushtet e lutjes	2:187; 34:53
një metodë e lutjes	17:111
katër qëllime të lutjes	40:61
për Profetin e Shenjtë <sup>savs</sup>	33:57
nënvlerësimi i saj	19:60

» <b>Lutja:</b> e Ademit	2:38; 7:24
lutja duele ( <i>mubahala</i> )	3:62
e mohuesve	25:78; 13:15; 40:51; 34:53
e hallexhiut	27:63; 41:50, 52
e idhujtarit	13:15; 7:195; 46:6
e lutësit	2:187; 2:202; 3:195; 6:163; 7:30, 56-57, 181; 9:103; 14:40; 17:111; 19:49; 20:15; 25:66; 32:17; 40:15, 61, 66; 66:9
<b>Lutjet e Kuranit:</b> lutja e përsosur	1:1-7
lutje për besim	5:84-85; 3:54
lutje për të kërkuar mirësitë e botës dhe të <i>ahiretit</i>	2:202; 7:157
lutje për të kërkuar mbrojtje nga nxitjet e shejtanit	23:98-99
lutje për të pasur qëndrueshmëri	2:251; 3:9; 7:127
lutje për të shpëtuar nga ndëshkimi i Zotit dhe nga poshtërimi në ditën e kiametit dhe për të pasur faljen, fundin e mirë dhe përmbushjen e premtimit të Zotit	3:192; 3:194-195
lutje për të kërkuar falje, mëshirë dhe ndihmën kundër armiqve	2:287
lutje për të kërkuar faljen e mëkateve	3:17; 3:148; 7:24; 11:48
lutje për të shpëtuar nga vështirësitë	21:88
lutje për të pasur forcë që të luftosh me të keqen	12:34
lutje për të gjetur shërim nga sëmundja	21:84
lutje të ndryshme për të kërkuar falje dhe mëshirë	7:156; 7:150; 7:152; 23:119; 28:17;
lutje për të kërkuar falje për popullin e humbur	5:119
lutje për të shpëtuar nga ndëshkimi i xhehenemit	25:66
lutje për t'u mbrojtur nga zilia	59:11
lutje e përlulur e engjëjve arshmbartës për besimtarët e sinqertë	40:8-10
lutje për mospërfshirje në mizori	4:76; 7:48; 10:86-87; 23:94-95; 66:12
lutje për të përparuar në dije	20:115
lutje për të kërkuar kthjelltësinë në shpirt, lehtësinë në punë dhe ndikimin në gjuhë	20:26-29



» <b>Lutjet e Kuranit:</b> lutje për të kërkuar përparime shpirtërore	66:9
lutje për të kërkuar vdekje gjatë besimit dhe për të pasur fund të mbarë	12:102
lutje për të kërkuar mirësi, <i>riskun</i> dhe paqen	2:127; 28:25;
lutje e dishepujve të Hazret Isait <sup>as</sup>	5:115
lutje për të gjetur fuqinë, <i>riskun</i> dhe për të shlyer borxhet	3:27-28
lutje për të kërkuar vendimin dhe fitoren prej Zotit	7:90
lutje për të kërkuar ndihmë kur pushtoheni nga të tjerët	54:11
lutje për të kërkuar shenjë vendimtare	26:118-119
lutje për mohuesit dhe përgënjeshtuesit	71:27-28
lutje për të kërkuar falje për veten, për prindërit dhe për besimtarët	17:25; 71:29
lutje për udhëzimin e njerëzve	2:130
lutje për të ndëshkuar armiqtë	10:89
lutje për të kërkuar ndihmë kundër popullit keqbërës, mohues	5:26; 26:170; 29:31
lutja e Hazret Musait <sup>as</sup>	28:18
lutje për të kërkuar gjykim	21:113
lutje për të kërkuar mëshirë dhe lehtësim në punë	18:11
lutje për fëmijë dhe pasardhës	2:129; 14:38-39; 14:41-42; 18:11; 37:101; 46:16
lutje për të kërkuar aftësinë e vendimmarrjes, sinqeritetin, emër të mirë dhe xhenetin	26:84-86
lutje për të pasur pushtet dhe forcë të jashtëzakonshme	38:36
lutje për të kërkuar bashkëshorte e fëmijë të dëlirë dhe për t'u bërë model i mirë për ta	25:75
lutje për të hipur në mjet udhëtimit	11:42; 23:30; 43:14-15
besimi në madhësinë absolute të Zotit dhe në premtimet e Tij	3:10
lutje për të pasur fillim dhe fund të mbarë dhe ndihmë të veçantë nga Zoti	17:81
lutje që veprat të kenë vlerë	37:181-183

» <b>Lutjet e Kuranit:</b> Lutje për t'u dërguar paqe njerëzve të zgjedhur të Zotit	27:60
lutje për t'u kthyer tek Allahu dhe për të kërkuar besim të përsosur	7:144
lutje për të pasur Zotin të mjaftueshëm	3:174
lutje për të kërkuar vendim hyjnor	39:47
lutje për të pasur ndihmën hyjnore gjatë kundërshtimit nga populli	23:27
shfaqja e besimit kur i dëgjon premtimet hyjnore	17:109
lutje që duhet bërë në mëngjes e në mbrëmje	9:129; 30:18-20
lutje e besimtarëve kur janë në vështirësi	2:157
lutje për t'i dedikuar fëmijën Zotit	3:36
lutje e robërve të Zotit përballë përbuzjes së përgënjeshtuesve	23:110
lutje për të pasur mbrojtjen e Zotit nga çdo e keqe; lutje për mbrojtje nga e keqja e jashtme dhe ajo e brendshme	112:1-5; 113:1-6; 114:1-7
një lutje e bukur për pranimin e adhurimeve dhe lutjeve	2:128
lutje për të hyrë në një vend, qytet a fshat	17:81
lutjet e Ibrahimit <sup>as</sup>	2:127-130; 2:125; 14:36-42; 26:84-88; 37:101; 60:5-6
lutje për të hyrë në një vend, qytet a fshat	17:81
lutje për udhëzim	1:6-7; 3:9; 18:11
lutje për të kërkuar të mira	2:202; 7:157; 28:25
lutje për të kërkuar falje	3:17; 2:286-287; 3:148, 194-195; 7:24, 150, 152, 156-157; 11:48; 12:102; 18:11; 21:88; 23:95, 110, 119; 25:66-67; 28:17; 35:38; 38:36; 40:8; 59:11; 66:9
lutje për shpëtim	2:287; 3:192; 4:76; 10:86-87; 21:84, 88-89; 23:98-9; 25:66-67; 26:170; 28:22; 38:42; 40:8-10; 59:11; 66:12
lutje për fitore përballë armikut	10:89; 2:287; 7:48; 10:86-87; 23:27, 98-99; 29:31; 60:5-6; 66:12; 71:27-28
lutje për ndihmë Hyjnore	2:251; 3:54; 4:76; 5:115; 21:90, 113; 23:27, 30; 29:31; 54:11
lutje për martesë	28:25
lutje për mbrojtje	11:48; 11:42; 43:14-15; 23:30; 113:2-6; 114:2-5
lutje për qëndrueshmëri	3:148; 2:251; 3:9; 7:127
lutje për të qenë i vërtetë (i dëlirë)	5:84-85; 12:102; 23:94-95; 26:84-88

» <b>Lutjet e Kuranit:</b> lutje për veten dhe familjen	14:36-42; 3:39; 17:25; 19:5-7; 21:90-91; 25:75; 26:170; 27:20; 37:101; 40:9-10; 46:16; 71:29
lutje kundër diskriminimit	5:26; 7:90; 26:119; 39:47
lutje për të kërkuar dije	20:115; 20:26-29; 2:33
lutje për të triumfuar e vërteta	7:90; 23:27; 26:118-19; 29:31
lutja e Iblisit	15:37; 38:80
lutje që bëhet në sexhden e leximit të Kuranit	7:207
<b>Lypja:</b>	93:11; 2:274; 22:37
<b>Llamba:</b>	24:36; 25:62; 33:47; 71:17; 78:14
<b>Llogaridhënia:</b> Allahu kërkon llogari	2:226; 2:285; 3:31; 4:41; 6:63; 17:37; 18:50; 19:85; 21:48; 24:40; 28:62, 85; 33:6; 37:128; 41:18; 42:23; 56:87; 58:7; 65:9; 68:40; 75:3; 83:6; 88:27; 99:8-9; 102:9
Allahu u kërkon llogari të Dërguarve	7:7
Çdokush është përgjegjës për veprat e veta	2:140; 4:86; 6:53, 70; 10:42; 13:19, 41; 23:118; 42:16; 64:5-8; 69:21
<b>Magjia:</b> rreth magjisë	2:103
magjistari nuk mund të ketë sukses	20:70
ata që thonë se Profeti Muhammed <sup>savs</sup> të ketë qenë i magjepsur, janë të padrejtë	113:6; 17:48
për hadithin që flet se Profetit Muhammed t'i kenë bërë magji	113:6
realiteti i magjisë; magjistarët	7:117-118
<b>Malet:</b>	7:172; 14:47; 16:82; 17:38; 19:91, 92; 33:73; 59:22; 70:10; 101:6
malet në shërbim të vazhdimësisë së jetës në tokë	f. 424
mjet që magazinon ushqim për njerëzit dhe kafshët	16:16; 79:33-34; 21:32; 31:11; 41:11
përmes maleve janë rregulluar mjetet e ushqimit në Tokë në katër periudha	41:11
malet në kuptimin e malësorëve të fortë	f. 728
malet në kuptimin e superfuqive	20:106-108; 81:4
ç'domethënë nënshtrimi i maleve për Davudin <sup>as</sup> ?	21:80; 38:19; 34:11
kur malet do të bëhen si lesh i shprishur	70:10; 101:6
u krijuan për njerëzit	16:16; 13:4; 15:20; 21:32; 22:19; 24:44; 27:62; 31:11; 35:28; 41:11; 50:8; 77:28; 78:8; 79:33; 88:20
mali Xhudij, ku u ndal arka e Nuhut	11:45

» <b>Malet:</b> Safa dhe Merva, vendet e shenjta	2:159; edhe 2:197, 204; 26:215
mali Sinai	2:41; 2:51, 64, 94; 4:155; 7:144, 172; 95:3
mali Tur	2:64; 2:94; 4:155; 19:53; 20:81; 23:21; 28:30, 45, 47; 52:3; 95:2-3
<b>Mallkimi:</b> lutje duele ( <i>mubahala</i> )	3:62; 3:65; 62:7
mbi mohuesit, idhujtarët, keqbërësit, mbi ata që i quajnë gënjeshtarë të Dërguarit dhe shenjat e Zotit	4:48; 2:89-90, 160, 162; 4:47, 53, 94, 119; 5:61, 79; 7:39, 45; 9:68; 11:19, 61; 13:26; 23:42, 45; 28:43; 29:26; 33:58, 62, 65, 69; 40:11, 53; 47:24; 48:7; 77:16, 20, 25, 29, 35, 41, 46, 48, 50
mbi hipokritët	63:5; 47:24; 48:7
mbi djallin	15:36; 38:79
mbi hebrenj (judenj)	5:14; 3:55; 4:47-48, 53; 5:61, 65, 79; 9:30; 17:61
mbi ata që shpifin për imoralitet	24:24; 24:8, 10
mbi gënjeshtarët	11:19; 3:62
mbi ata që vdesin mohues	2:162; 3:88
mbi ata që spekulojnë dhe përhapin dyshime	51:11
mbi ata që falen për sy e faqe	107:5
<b>Mana dhe Selva:</b>	2:58; 7:161; 20:81
<b>Manastiri:</b> mbrojtja e tyre	22:41
<b>Martesa:</b>	2:224; 2:188, 222, 223, 225-238; 4:20-26, 128; 5:6; 7:190; 16:73; 23:6-7; 24:33-34; 30:22; 33:5; 58:2-6; 65:2-8
qëllimi	4:25; 30:22
ndalohet me këto	2:222; 4:23-25; 60:11
jepi përparësi besimit kur zgjedh bashkëshort-in/en	2:222
dhurata martesore ( <i>mehr</i> )	4:5; 2:237-238; 4:5, 4:21, 25, 26; 5:6; 33:50; 60:11
dhurata martesore ( <i>mehri</i> ) është obligim	4:25
burri t'i japë <i>mehrin</i> me gjithë dëshirë	4:5
gruaja mund t'ia falë <i>mehrin</i> , nëse do	4:5
nëse <i>mehri</i> nuk ishte përcaktuar më parë, duhet përcaktuar në bazë të jetesës së burrit	2:237
është besë e fortë	4:22; 4:128, 130
me ato që janë në pronësi dhe me të vejat	4:26; 4:128; 24:33-34
me refugjatet	60:11-12

» <b>Martesa:</b> ndalesat	2:223; 2:229, 235
ndalimi i marrëdhënieve bashkëshortore	2:188; 2:223, 227; 12:33
poligamia	4:4; 4:128, 130
propozimi	2:236
afati i pritjes ( <i>iddet</i> ) për gruan, së cilës i vdes burri, ose që divorcohet prej tij	2:229; 2:235; 33:50; 65:2, 5;
nxitje për të martuar të vejat	4:33
murgëria është risi nga vetë njeriu, dhe jo porosi e Zotit	57:28
<b>Marrëveshjet:</b>	9:4; 2:74; 3:29; 4:92; 8:73; 9:2, 7, 12-13; 16:92-93, 95; 33:16, 27; 48:2
<b>Matja:</b> e Allahut	25:3; 3:28, 38; 13:9, 18; 15:22; 23:19; 24:39; 32:6; 36:39; 39:11; 40:41; 41:11, 13; 42:28; 43:12; 54:50; 55:8-9; 65:4; 70:5; 77:23; 80:19-20
dhe peshimi	6:153; 7:86; 11:85-86; 12:60-61, 66, 89; 17:36; 26:182; 55:10; 76:17; 83:2-4
<b>Mbështetja tek Allahu:</b> ( <i>tevekkul alallah</i> )	65:3-4; 3:123; 3:160-161; 4:82, 133, 172; 5:12, 24; 7:90; 8:3, 50, 62; 9:51, 129; 10:72, 85-86; 11:57, 89, 124; 12:68; 13:31; 14:12-13; 16:43, 100; 25:59; 26:218; 27:80; 29:60; 33:4, 49; 39:39; 42:11; 58:11; 60:5; 64:14; 67:30
<b>Medina:</b> Jethrib	33:14, 61; 9:101, 120; 63:9
<b>Mehdiu:</b> i udhëzuar prej Zotit	21:74; 75:10; 85:4 Shih edhe: <b>Mesihu i Premtuar</b>
<b>Meka:</b>	3:97-98; 2:127; 14:36; 27:92; 28:58; 29:68; 90:2; 95:4; 7:99; 14:38
si qendër spirituale	42:8; 2:126-127, 151, 192; 3:97; 6:93; 14:36-38; 27:92; 28:58; 95:4
çlirimi dhe fitorja e saj	28:86; 2:151; 6:116; 9:1-2; 14:49; 34:27; 37:21; 44:17; 54:8-9; 70:43-45
profeci për çlirimin e saj	28:86; 2:150; 17:81
<b>Menstruacionet:</b>	2:223; Shih edhe: <b>Martesa</b>
<b>Merjemja</b> <sup>as</sup> : historia e saj	4:172; 5:76; 3:43-48; 3:36-38; 19:17-29
lindja e Isait <sup>as</sup>	19:26; 3:46; 19:18, 24, 28-29
përgënjeshtrimi i shpifjeve ndaj saj	4:157
» <b>Merjemja</b> <sup>as</sup> : e përzgjedhur	3:43-46; 21:92; 66:13
mohimi i të qenit zota	5:117
shembull për besimtarët	66:13
familja e saj	3:34, 36-38

<b>Mesihu i Premtuar:</b> është prej <i>umetit</i> të Profetit Muhammed	62:2-6; 11:18; 66:12-13
Imam Mehdiu nuk do të bëjë gjakderdhje	5:15
është Profet, por shërbëtori i përsosur i Profetit Muhammed	33:41; 4:70; 7:36; 1:7; 22:76; 33:41; 33:8; 3:82; 40:35
pse Mesihu i Premtuar u quajt biri i Merjemes?	66:12-13
zbritja e tij nuk do të ishte fizike	65:11-12 Shih edhe: <b>Isai</b> <sup>as</sup>
çfarë nënkupton ardhja e dytë e një Profeti	3:40; 2:56
shembuj të fjalës zbritje ( <i>enzele</i> ) në kuptimin jofizik	65:11-12; 17:94; 57:26; 39:7; 7:27; 6:8; 10:60; 20:81
profecitë për kohën e tij; cila është koha e ardhjes së tij?	62:3-6; 61:10; 32:6; 81:1-19; 85:2-5; 16:78; 44:12; 84:19-20; 89:2-6
mesihu i premtuar dhe kiameti, domethënie	54:2; 16:78
ai dhe xhemati i tij do të përballej me persekutim të ashpër	85:2-11
Dexhalli	21:97; 40:58; 18:111
Jexhuxhët e Mexhuxhët	18:93-101; 21:97
dalja e <i>dabbetular</i> -it (krimbi prej toke)	27:83
dy periudha të Islamit	62:2-6; 48:30; 56:40-41
epoka e sakrificave financiare me shumicë	f. 1014
profecia që ndjekësit e tij do të persekutohen	f. 1120
shtimi i hipokritëve në mesin e muslimanëve	f. 1011
muslimanët do t'i japin përparësi botës mbi besimin	f. 1007
<b>Metalet:</b>	55:36; 18:97; 22:22; 34:11, 13; 44:46; 57:26; 70:9
<b>Meteorët:</b>	15:19; 37:11
<b>Mëkati:</b> gjynahu; ruhu prej tij	2:220; 2:189, 277; 4:21, 26; 5:3, 63-64; 53:33; 58:9-10; Shih edhe: <b>Spiritualizmi</b>
shkaqet	74:44-47; 2:207; 41:24; 68:13-15; 114:2-6
pasojat	4:124; 2:82, 86; 4:112-113; 91:11
pendesa, shpëtimi	4:18; 16:120

» <b>Mëkati:</b> falja e mëkateve	3:32; 3:136, 148, 194; 4:18, 32, 49, 111, 117; 5:13, 66; 6:55; 7:154, 157; 12:30, 34, 88, 98; 14:11; 15:57; 18:59; 29:8; 33:71-72; 39:54; 40:56; 42:26; 46:17, 32; 47:3, 20; 48:3; 61:13; 64:10; 65:6; 71:5
të mëdhatë	17:32-37; 4:3, 32, 49, 51; 25:69; 33:54, 59; 42:38; 53:33
njeriu është krijuar pa mëkat	30:31; 75:3; 91:8-9; 95:5-6; 7:43; 7:23; 49:8; 76:3-4; 90:9-11; 91:8-9; 95:5-6
nuk quhet mëkat	2:174; 2:159, 183, 199, 204, 230-231, 234-235, 237, 241, 283; 4:24-25, 102-103, 129; 5:94; 24:30, 59, 61-62; 33:6, 52, 56; 52:24; 60:11
<i>shirku</i> , mëkati më i madh	31:14; 4:49; 4:19, 117
i hapur dhe i fshehtë	6:121; 6:152; 7:34
ndëshkimi për të	10:28; 2:82; 3:12; 5:19, 50; 6:7, 161; 7:101; 8:53, 55; 28:79, 85; 40:41; 45:34; 91:15
shlyhet	13:23; 4:32; 5:46; 11:115; 16:120; 25:71; 40:10; 53:33
parandalohet	29:46; 3:32; 4:32; 7:201; 11:115; 39:55-56; 53:33
<b>Mëshira:</b> e Allahut	1:1-4; 2:38, 65, 106, 129, 158, 179, 188, 219; 3:9, 75, 108, 129, 133, 158; 4:27-28, 84, 93, 97, 114, 172, 176; 5:40, 72; 6:13, 17, 55, 134, 148, 156; 7:57-58, 64, 73, 152, 155-157, 205; 9:21, 99; 10:22, 87; 11:10, 44, 74, 120; 12:65; 16:65; 17:9, 55, 58, 88; 18:17, 59; 39:54
për besimtarët	7:50; 2:219; 3:108; 4:27-28, 84, 96-97; 9:71; 10:58; 12:57, 112; 15:89
për mosbesimtarët	3:129; 15:57
për prindërit	17:25
Kurani si mëshirë	6:158; 7:53, 204-5; 16:90; 17:83
mbi Profetin <sup>savs</sup>	3:160; 4:114; 9:61, 117; 11:18; 21:108
mbi Profetët e tjerë <sup>as</sup>	11:48; 11:29, 59, 67, 95; 12:54, 88, 93
mbi të penduarit	4:18; 7:24, 150; 9:118
lutje për mëshirë	2:287; 3:9; 18:11
<b>Midjani:</b> (Medjeni)	15:79; 2:251; 7:86-94; 11:85, 95-96; 18:61, 66; 20:41; 22:45; 26:142; 27:19; 28:23-24, 46; 29:37, 41
<b>Mirat (të):</b> furnizimet	20:132
Allahu i shton	13:27; 17:31; 28:83; 29:63; 30:38; 34:37, 40; 39:53; 42:13, 28

» <b>Mirat (të):</b> Allahu i furnizon	5:115; 2:58, 173, 213; 3:38; 5:89; 7:161; 8:75; 11:7; 16:72, 115; 20:82, 132; 22:51, 59; 23:73; 24:39; 29:61; 34:5; 51:23, 59; 62:12
shpirtërore	2:198; 37:42; 38:55; 51:58; 65:12
e kësaj bote	2:241; 2:237; 3:15; 5:97; 8:5; 8:75; 10:60, 99; 11:4, 7, 89; 12:60, 66; 14:31; 16:72, 76; 17:19; 20:132-133; 22:51, 59; 24:27; 28:58; 33:32, 50; 34:5, 16; 40:40; 42:37; 43:30, 36; 45:6; 50:12; 67:16, 22; 79:34
<b>Miraxhi:</b> ngritje shpirtërore	53:8-18 Shih edhe: <b>Isra</b>
<b>Mjalti:</b> Allahu i shpalli bletës	16:69
shembulli i bletës tregon madhështinë e shpalljes	f. 425
mjalti ka shërim	16:70
krahasimi mes mizës dhe bletës	f. 425
referenca të tjera	2:58; 47:16; 66:2
<b>Mjekësia:</b> shërimi	16:70; 23:52; 28:73; 47:16
shërimi shpirtëror	17:83; 10:58
<b>Mohimi:</b> mohimi dhe mohuesit	2:7-21; 2:35; 3:5, 98; 4:151-152; 5:18, 37, 38, 45, 73-74; 7:38, 51; 8:56; 9:37; 12:88; 14:3-4; 16:108; 19:72; 38:74-75; 39:33, 60; 40:5; 45:12; 47:35; 85:11, 20-21; 98:7; 109:2-7
<b>Mohuesit:</b> xhihad me ta përmes Kuranit	25:53
sfidë për ta	2:24; 8:32; 10:39; 11:13-14; 17:89; 22:16; 52:34-35
ndjekin verbërisht gjurmët e të parëve	2:171
të mashtruar	13:34; 2:109; 3:168, 178; 6:123, 131; 9:23
nuk ka falje për këta	4:138; 4:169; 13:15; 32:30; 40:51; 47:35
ndëshkimi për ta	2:25; 2:40, 91, 105, 127, 176; 3:11, 23, 57, 92, 132, 142; 4:19, 38, 57, 141, 152, 162; 5:11, 87; 6:31, 111; 7:51; 8:15, 37; 9:26, 49, 68; 13:36; 14:3; 16:28; 17:9; 18:103, 107; 21:40; 22:20, 73; 29:55; 33:65-66; 34:34; 35:37; 36:64-65; 38:28; 39:33, 72; 41:51; 48:14; 67:7; 70:2-3; 76:5; 98:7
<b>Morali:</b> çështje të moralit; virtyte dhe vese	16:91
<i>arroganca; mendjemadhësia</i>	2:35, 88; 4:174; 7:14, 37, 41, 49, 56, 76-77, 89, 134, 147; 10:76; 14:22; 16:24, 30; 17:38; 23:47; 25:22; 28:40, 84; 29:40; 31:19-20; 34:32-34; 38:3, 75-76; 39:60; 40:36, 48-49, 57; 41:16, 39; 44:50; 45:32; 46:11, 21; 57:24; 71:8; 74:24; 41:51;



» <b>Morali:</b> mendjemadhësia	31:19; 7:14
Allahu nuk e do mendjemadhin	4:37; 16:24
shkak i ndëshkimit	4:174; 7:37, 41; 39:73; 40:36, 77
mendjemadhi nuk hyn në xhenet	7:41; 39:73; 16:30
për shkak të mendjemadhësisë, Iblisi nuk bëri sexhde për Ademin	2:35
mohuesit i refuzojnë Profetët për shkak të mendjemadhësisë	7:37
mendjemadhit Allahu ia vulos zemrën	40:36
<i>bashkëpunimi</i>	5:3; 13:24
<i>mbështetja te Zoti</i>	14:13; 25:59
<i>besueshmëria</i>	4:59; 2:284; 8:28; 23:9; 70:33-34
<i>drejtësia; Allahu urdhëron drejtësinë</i>	16:91; 5:9; 4:136
Allahu i do ata që bëjnë drejtësi	49:10
bëni drejtësi edhe sikur tjetri të jetë ndonjë i afërm juaji	6:153
nuk duhet t'ju nxisë armiqësia e ndonjë populli, që ju të mos bëni drejtësi	5:9
drejtësia; referenca të tjera	2:49, 283; 3:19, 109; 4:4, 31, 59, 106, 136; 5:9, 43, 50; 6:83, 116, 152-153; 7:30, 160, 182; 15:9; 16:77; 25:5; 28:29; 38:23, 27; 39:70, 76; 40:18, 32, 79; 49:10; 55:9-10; 57:26; 72:14
<i>durimi</i>	2:46; 2:156, 178; 3:187; 6:35, 85; 7:88; 12:19, 84; 14:13, 22; 16:127-128; 18:68-69, 73, 79, 83; 21:86; 40:56; 42:44; 46:36; 50:40; 52:17; 54:28; 70:6
<i>dyshimi</i>	17:37; 24:7; 49:13
<i>egërsia</i>	17:27-28; 17:30
trazira më e madhe në botë është t'i ndërrosh me dhunë fenë tjetrit	f. 275-276
nuk ka dhunë në fe	2:257; 18:30; 109:7; 6:150
<i>ekstravaganca</i>	25:68; 4:7; 7:32; 10:13; 17:27-28, 30; 43:6; 44:32; 72:5
<i>koprracia</i>	4:38; 57:25; 59:10; 64:17; 47:39
<i>falja</i>	24:23; 2:110; 3:135, 160; 4:150; 5:14; 7:200; 12:93; 42:38-41
<i>falja e tjetrit</i>	16:126; 42:41
<i>filantropia; mirësia; bamirësia</i>	2:178; 2:216; 24:23, 34; 51:20
<i>gënjimi</i>	22:31; 6:22, 149; 7:153; 10:60-61; 11:51; 12:111; 16:117; 25:73; 39:33; 72:5

» <b>Morali:</b> grumbullimi i pasurisë	70:19; 104:3-5
<i>gjuha e pahijshme</i>	24:27
<i>hakmarrja</i>	22:61; 42:41; 41:35
<i>hipokrizia</i>	2:11
<i>këmbëngulja</i>	13:23; 2:154, 156
<i>komplotimi</i>	4:82; 58:8-11; 52:43, 47
<i>kumari</i>	2:220; 5:91-92
<i>kurvëria</i>	17:33; 25:69
<i>maturia; mosteprimi</i>	7:32; 25:68
<i>mikpritja</i>	15:69-70; 11:70; 17:27
<i>mirënjohja; falënderimi</i>	3:145; 31:13; 2:153, 173, 186, 244; 5:7, 90; 14:8, 29; 16:113; 27:41; 28:74; 29:67; 34:18; 39:8, 67; 46:16; 80:18; 31:13; 31:33
<i>mirësia</i>	17:24-25; 2:84, 178, 216, 242, 264, 281; 4:6, 9, 37; 5:55; 6:152; 7:200; 9:61; 16:91; 17:29; 29:9; 30:39; 31:15, 16; 33:50; 51:20; 60:9; 76:9; 90:14-17
<i>mëshira ndaj kafshëve</i>	70:26
<i>modestia</i>	24:31-32
<i>ndershmëria seksuale</i>	24:31-32; 17:33; 23:6-8; 24:3-4, 20, 27, 34, 61; 25:69; 33:36; 70:30-32
<i>nxitimi</i>	21:38; 4:7; 20:115; 46:36
<i>pajtimi</i>	49:10; 2:225; 4:115
<i>pandershmëria</i>	4:108; 11:85; 22:31; 83:2-4; 40:20
<i>pastërtia</i>	2:223; 2:126; 4:44; 5:7; 7:32; 9:103, 108; 22:27, 30; 24:22; 33:34; 53:33; 56:80; 74:5-6; 87:15; 91:10-11
<i>përgojimi</i>	104:2; 49:13
nuk duhet t'ia besosh fjalën përgojuesit	68:11-12
<i>përmbushja e premtimit</i>	17:35; 2:178; 16:92; 23:9
<i>përqeshja; vënia e nofkave</i>	49:12; 111:2
<i>zbutje në parimet për hir të tjetrit që është mohues (arab. mudahene)</i>	68:10
<i>përrulësia; thjeshtësia</i>	25:64; 1:5; 2:46, 75; 3:18; 5:55; 6:43, 44, 64; 7:56, 95, 162; 11:24; 12:33; 16:49; 17:25, 38- 39, 110; 20:112, 135; 21:91; 22:35, 55; 23:3, 77; 27:38, 88; 31:19, 20; 33:36; 49:4; 57:17
<i>ryshfeti; mitëmarrja</i>	2:189; 16:96-97
<i>sinqeriteti</i>	4:147; 2:140; 7:22, 30, 63, 69, 80, 94; 9:91; 10:23; 11:35; 12:12; 28:13; 29:66; 30:34; 39:3- 4, 12, 15; 40:15, 66; 98:6

» <b>Morali:</b> <i>shpifja</i>	49:7, 12; 24:2, 20
<i>shpirti i sakrificës</i>	3:93
<i>të bësh të mira</i>	2:149; 2:196; 3:111, 135; 5:94; 7:57; 10:27; 23:98
<i>të gëlltitësh zemërimin</i>	3:135
<i>tradhtia</i>	4:108; 4:106; 9:8, 80; 22:39; 31:33; 33:27; 48:59
<i>tradhtia e syve</i>	40:20; 17:37
<i>trimëria; kurajo; guximi</i>	46:14; 2:178; 3:153, 173-175; 11:107; 21:84; 8:16
<i>uniteti, bashkimi</i>	3:104
<i>të ushqesh të varfrit</i>	76:9-10; 90:15-17
<i>vetëmohimi</i>	59:10; 2:208; 2:263; 11:52; 64:17; 76:9-10; 92:20-21
<i>vërtetësia</i>	25:73; 3:61; 4:136; 5:76, 120; 9:118-119; 10:17; 16:117; 17:82; 19:42; 22:31; 33:9, 25, 36, 71; 39:4, 33; 103:3-4
<i>tekija (maskimi) nuk ka asnjë bazë në Islam</i>	10:83
<i>vjedhja</i>	5:39; 60:13
<i>vrasja</i>	25:69
<i>zelli</i>	47:37-39; 3:181-182; 4:38; 9:35, 76; 17:101; 25:68; 33:20; 57:25; 64:17; 68:26; 70:22; 81:25; 92:9-11
<i>zilia</i>	113:6; 2:110, 214; 3:20; 4:55; 45:18; 48:16
<i>kotësia; biseda boshe</i>	23:4; 6:92; 9:69; 28:56; 46:9; 52:13; 70:43; 74:46
<b>Mrekullitë:</b> e Profetit të Shenjtë <sup>savs</sup>	17:91-94; 8:18; 9:25-26; 10:21; 13:8; 54:2; 85:4
e Isait <sup>as</sup>	3:50; 5:111; 19:33
e Musait <sup>as</sup>	7:108-109; 2:61; 7:118, 134; 17:102; 20:19-24; 27:13
<b>Muajt:</b>	9:36; 2:186, 195, 218; 4:93; 5:3, 98; 34:13; 46:16
muajt e shenjtë	9:5; 9:36; 2:195
<b>Muhamedi</b> <sup>savs</sup> : <i>salavatet dhe selam atij</i>	33:57; 68:4
ardhja e tij	61:7; 2:90, 130, 152; 3:145, 165; 5:16; 6:21; 9:128; 14:36-38; 28:47; 35:17-18; 45:19; 46:36; 62:3; 30:42
emri “Muhammed” në Kuran	3:145; 33:41; 47:3; 48:30

» <b>Muhamedi</b> <sup>savs</sup> : emrat (cilësitë) e tjerë të tij	61:7; 2:120; 13:8; 21:108; 33:41, 46; 42:49; 53:57; 72:20; 73:2, 16; 74:2-3; 88:22-23
emri i tij “Ahmed” në Kuran	61:7
moralet e tij; ndershmëria e tij	68:5; 10:17
dhe të krishterët	5:84-85; 2:121, 146; 18:7, 78
dhe mohuesit	15:89-98; 2:7, 110, 119, 192, 218; 3:33, 128, 177, 197; 4:91, 103; 5:42, 55; 6:34; 8:31; 9:2, 4, 32, 40, 73, 123; 10:66; 11:13; 13:28; 15:3; 16:128; 18:7; 20:134; 22:16; 25:5; 26:4; 27:71; 28:57; 29:51; 35:5, 9; 36:77; 41:6; 48:30; 52:34; 66:10; 68:52; 73:11; 93:6; 94:2-4
dhe hipokritët	3:163-164; 9:58; 9:64-68
dhe ata që e lëndojnë	33:58; 9:61
dhe Profetët e tjerë	6:35; 2:130; 3:69; 5:20; 29:19; 36:15; 41:44; 73:16; 95:2-4
dhe hebrenjtë	45:18; 2:103, 121, 146; 3:120; 10:94
“Profet i pashkolluar”	7:158-159; 29:49; 62:3
në Bibël; e shoqërojnë dy shenja madhështore	7:158; 46:11
dhe e padukshmja	6:51; 11:32
dhe Kurani	16:104; 2:98; 3:145; 10:16; 11:13; 15:88; 16:45; 17:75; 26:193-196; 47:3; 73:6
si dritë; shembull i dritës së Allahut	33:46-47; 4:175; 5:16-17; 24:36; 61:9; 64:9
virtytet e tij të larta	68:5
njeri i vdekshëm	18:111; 12:110; 14:11-12; 16:44; 17:94-95; 21:4, 8, 35; 23:25, 34; 26:155; 36:16; 41:7; 64:7
paralajmërues	35:24-25; 7:189; 10:3; 11:13; 18:5; 25:2; 32:4; 33:46; 34:29, 47; 36:7; 38:5, 71; 46:10; 48:9
ngjitja e tij	17:2; 53:2-19; 17:94
autoriteti i tij	24:52-55; 4:14, 70; 9:71; 10:50; 33:37, 72; 48:18
betejat e tij	59:3; Shih <b>Beteja ...</b>
sahabët e tij	24:38-39; 3:160; 5:23; 7:158; 8:6; 9:100, 117, 128; 26:220; 33:24; 47:5; 48:30; 66:9; 77:2-7; 79:2-6; 92:4; 100:2-12
këshillimi me të	58:13-14; 3:160
përkujdesja Hyjnore ndaj tij	8:68; 9:43; 33:38; 66:2; 80:2-12
përkushtimi i tij ndaj Allahut	73:21; 2:130; 3:32; 6:163
mërgimi	28:86; 9:40; 23:95; 39:54 Shih edhe: <b>Hixhreti</b>

» <b>Muhamedi</b> <sup>savs</sup> : armiqhtë	8:31; 4:114-116; 6:22; 8:34; 9:61; 3:11-12; 23:94-99; 27:49-52
bekimet ndaj tij	48:3; 25:11; 93:4-9; 94:2-7; 108:2-4
Vula e Profetëve	33:41; 4:70; 7:36; 33:8; 3:82; 62:4; 24:56; 22:76; 72:8; 44:6, 7; 40:16; 16:3; 36:66
ndjekësit e tij	3:111; 2:144; 3:160; 9:128; 11:113; 26:10, 216; 33:7; 47:3
<i>umeti</i> i tij do të ngjajë me <i>umetin</i> e Musait <sup>as</sup>	1:7; 10:15
krahasimi i tij me Musain <sup>as</sup>	5:25; 9:40; 18:62
paqe dhe mëshirë për njerëzimin	21:108; 18:7; 3:160; 9:128; 15:98; 16:76; 18:29; 26:4-5; 27:71; 35:9; 36:77; 43:89-90; 93:8
“A do të vrasësh veten se pse ata nuk po bëhen besimtarë?!”	26:4
ndërmjetësimi i tij	43:87; 19:88; 53:10; 9:103
lutja e tij për besimtarët është afruese për ta	9:99
thirrje për mallkimin e Allahut	3:62; 62:7-8
drejtësia e tij	5:43; 5:49-50
modeli për njerëzimin	33:22
pozita e tij e lartë	81:20-22; 4:70; 13:5; 17:75, 80; 20:2; 25:62; 33:22, 41, 47; 36:2, 14; 48:2-3; 53:2-6; 55:4; 68:5; 72:20; 74:2-6; 91:2-7; 94:2-4; 95:2-3; 108:2; 33:73
mesazhi i tij	5:68; 6:20, 51, 107, 163-164; 7:158-159, 204; 8:25; 10:16, 110; 21:46; 22:68; 23:74-75; 25:2, 53; 29:19; 33:3; 34:44, 47; 36:2-8; 42:53; 43:44; 46:10; 53:3; 62:3
mrekullitë e tij	8:18; 54:2
detyra e tij është vetëm kumtimi, e jo mbikëqyrja	6:105; 4:81, 85; 6:67, 108; 11:13; 39:42; 42:7, 49
bindja ndaj tij	3:32; 4:65-66, 70, 81; 48:11
kundërshtimet ndaj tij	21:4; 6:9, 38; 7:185, 204-205; 10:50; 11:13; 16:104, 114; 17:91-94; 21:6; 25:5-10, 33; 26:225-228; 34:47; 35:26; 36:70; 38:9-10; 42:25; 48:3; 52:30, 34-35; 53:3, 20-24, 63; 68:3-7; 69:42-48; 81:23
durimi i tij	6:35; 7:200
lutjet e tij	Shih: <b>Lutjet e Kuranit</b>
mbrojtja e tij	5:68; 8:6; 13:12; 33:2; 47:14; 52:49; 93:4-5
respekti i tij	2:105; 9:61; 24:63-64; 49:2-6

» <b>Muhamedi</b> <sup>savs</sup> : shpalljet	53:3-13; 2:100; 3:45; 4:164; 5:68; 6:20; 10:3; 11:13; 12:4; 13:31; 14:5; 16:124; 17:40; 18:28; 21:109; 29:46; 34:51; 35:32; 38:71; 42:4
i pastër nga mëkati	48:3; 53:3
statusi i tij	53:2-19; 36:2
Profeti	33:2; 5:82
vërtetësia e tij	34:45-51; 3:82; 10:17; 11:18; 21:6; 23:70; 36:2-4; 43:87; 47:3; 69:39-48; 90:4
universaliteti i tij	7:159; 2:214; 3:85; 4:80; 6:93; 10:58; 14:5; 21:108; 22:41, 50; 23:53; 25:2; 34:29
miraxhi	53:8-18; 7:144
israja	17:2; 17:61
ëndrrat/ <i>keshfet</i>	48:28; 17:2, 61
gratë e tij	33:7; 24:12-17; 33:29-35; 33:38-39; 33:51-54; 66:2-6
t'i tregosh respektin maksimal	49:3
mos e thirrni si njeri të zakonshëm	24:64
mos ngrini zërin para tij	49:3
jepni <i>sadaka</i> para se të këshilloheni me të	58:13-14
<b>Muhsin</b> : ata që bëjnë mirë, mirëbërës	3:135; 2:196; 3:149; 5:14, 94; 9:120; 11:116; 12:57, 91; 31:4
do të shpërblehen	29:70; 2:59, 113; 4:126; 5:86; 6:85; 7:57, 162; 12:23; 22:38; 28:15; 31:23; 33:30; 37:106, 111, 122, 132; 39:35; 77:45
<b>Murgëria</b> :	57:28; 5:83; 9:31, 34
<b>Murtaja</b> : sëmundje	27:83; 7:134-135; 27:13; 105:2
<b>Musai</b> <sup>as</sup> : dhe Haruni <sup>as</sup>	26:14; 20:26-36; 25:36; 28:35-36; 7:143
dhe Profeti <sup>savs</sup>	11:18; 2:109; 7:145; 20:30; 28:31, 45-46; 46:11; 52:2-7; 95:2-4
dhe izraelitët	61:6; 5:26-27; 7:106, 160; 10:84-94; 17:5-9; 26:53; 28:6-7;
dhe Faraoni	2:50-51
ai dhe grindja e dy njerëzve	28:16-23
bekimet e dhuruara	6:155; 2:249; 37:115-123
është quajtur i çmendur	26:28
jeta e hershme e tij	28:8-29; 20:39-41
eksodi	20:78-81; 2:51; 7:129, 139; 10:91-94; 26:53, 61-67; 44:24-25
martesa e tij	28:28-29

» <b>Musai</b> <sup>as</sup> : takimi me Zotin	7:143-148; 2:52; 27:8-10; 28:30-36
nëna e tij	20:39-40
Profet i bijve të Izraelit	26:11; 4:165; 7:105-106, 145; 11:97- 98; 17:3-4; 23:46-47; 28:45
profetët mëkëmbës të tij	2:88; 5:47; 25:36
shpalljet e tij	2:54; 6:92, 155; 7:161; 23:50
dhe shenjat e Allahut	7:108-109; 2:61; 7:118, 131, 134; 17:102; 20:18-24; 20:67-70; 26:33-34, 64; 27:11, 13-15; 28:32-33; 79:21
nëntë shenjat e tij	27:13; 7:134
bardhësia e dorës së tij nuk qe për shkak të ndonjë sëmundjeje	20:23
mrekullia e çarjes së detit, një shpjegim	26:67
premtimi i Zotit për 30 net, i plotësuar me 10 të tjera	7:143
“O Zoti im! Dukmu që unë të Të shoh”	7:144
shpifje dhe akuza ndaj tij	33:70; 26:15; 28:16-21; 61:6
udhëtimi shpirtëror i tij	18:61-71
historia e tij	7:104-156; 10:76-93; 11:97-98; 17:102- 105; 19:52-54; 20:10-99; 26:11- 69; 27:8-15; 28:4-41; 79:16-27
pllakat e tij	7:146; 7:151, 155
faltore	52:6
vizioni i tij	27:8; 20:11; 18:72-83
“dhjetë urdhëresat”	2:54; 7:146, 151, 155
<b>Muslimanët:</b>	3:111; 33:28
dhe drejtësia	4:136; 5:3, 9; 6:153
kush quhet musliman?	4:95
dhe jomuslimanët	3:29; 3:101, 119-121, 150, 197-198; 5:3, 52-53, 58-59; 60:9
dhe Kurani	6:156; 7:3; 17:10; Shih edhe: <b>Kurani</b>
një popull i lartësuar	2:144; 3:111; 6:166
besimet	2:137; 2:166, 178
të promovojnë mirësinë	3:105; 2:149; 20:132
synimi i tyre	2:149
përsëritjesin njëri-tjetrit	4:87; 4:95
emërtimi; kush është musliman	22:79; 2:134; 4:95; 49:12, 15
detyrimet e tyre	2:196; 11:113; 47:23
cilësitë e tyre	4:60; 5:3, 101; 8:73, 75; 9:124

» <b>Muslimanët:</b> e përkujtojnë Allahun	2:153; 17:110
mospëlqimi i luftës	2:217-218; 8:58-59
përpiqen në rrugën e Allahut	2:245-246; 8:75; 9:88
të nënshtruar	29:47; 2:133-134, 137; 3:53, 103; 7:127; 16:90, 103; 21:109; 22:79; 27:82; 30:54; 41:34; 43:70
uniteti i tyre	3:104; 6:160; 61:5
<b>Muzdelife:</b> pjesë e Haxhit	2:199; 236 114
<b>Namazi:</b> forma e namazit	22:27
ç'është namazi? brendësia e namazit	29:46
porosia për namazin	2:44; 2:84, 111, 133, 153, 154; 4:78, 104; 5:56; 6:73, 93, 163; 8:4; 9:71; 14:32; 20:133; 22:79; 23:3, 10; 24:57; 27:4; 31:5, 18; 62:10; 70:24; 98:6
mrekullia e namazit	29:46
Allahu ia pranon adhurimet namazfalësit	3:196; 11:62; 42:27; 87:16; 46:6
besimtarët falen	7:30; 87:16
në udhëtim dhe në luftë	4:102-104; 2:240; 37:2
namazi i së xhumasë	62:10-12
është obligim në kohët e caktuara	4:104
ruajini namazet, sidomos namazin e mesit; ti e ruan namazin, namazi të ruan ty	2:239
çfarë do të thotë “të lartësosh namazin” ( <i>ikametus-salat</i> )	2:4
lutju Zotit përmes durimit dhe namazit	2:46
jeta shpirtërore e njeriut varet nga lartësimi i namazit	f. 693
shenjë e besimtarit: kryen me vazhdimësi namazet e tij	70:24
besimtarët i ruajnë namazet e tyre	23:3, 10; 24:38
mos iu afroni namazit kur jeni të trullosur	4:44
të gjithë Profetët ishin të porositur për namazin	21:74
lutja e Ibrahimit që populli i tij t'i përmbahet namazit	14:41
djalli tenton t'ju mbajë larg namazit	5:92
namazi i pesë vakteve	4:104; 20:131; 22:27; 7:206; 11:115; 50:40; 52:49-50;
namazi i <i>tehexhudit</i> (i natës)	17:80; 76:26-27; 32:17; 50:41; 73:3-9, 21
namazi të ndalon nga të këqijat	29:46



» <b>Namazi:</b> për ata që i ndalojnë të tjerët të falen	2:115; 72:20; 96:10-11
ata që janë të shkujdesur në namazet e tyre	107:5-6; 4:143; 9:54;19:60; 41:52; 74:44; 75:32-33
përtacia në namaz është shenjë e hipokrizisë	4:143
abdesi para namazit	5:7; 4:44
raste të caktuara kur <i>gusli</i> është obligim përpara namazit	4:44; 5:7
në disa raste, lejohet <i>tejemumi</i>	4:44; 5:7
disa njerëz do të përqeshnin muslimanët për <i>ezanin</i>	5:59
<b>Nata:</b>	2:52, 188; 7:143; 74:34; 78:11; 81:18; 84:18; 91:5; 93:3
për të bërë lutje	73:7; 3:114; 11:115; 16:76; 17:79-80; 20:131; 21:21, 43; 25:65; 39:10; 41:39 ; 50:41; 51:18; 52:50; 73:3, 21; 76:27
për të pushuar	6:97; 10:68; 27:87; 28:74; 30:24; 40:62; 41:38-9
fatkeqësi, vdekje	7:5; 6:61; 7:98; 10:25, 51
thurja e kompleteve gjatë natës	4:82, 109; 34:34; 13:11
dhe shenjat e Allahut	17:13; 3:28, 191; 6:14, 97; 7:5, 55, 98; 10:7, 68; 13:4; 14:34; 16:13; 21:34; 22:62; 23:81; 24:45; 25:63; 28:72-74; 31:30; 35:14; 36:38, 41; 45:6; 79:30
shpallja e Kuranit	44:4
<b>Nata e Kadrit:</b>	97:2-6; 44:4-5
Natyra:	67:4-5; 13:4-5; 18:8
<b>Ndershmëria seksuale:</b>	24:31-32; 24:3-4, 20, 27; 5:6; 23:6; 33:36; 70:30-31
shembuj	19:21; 12:24-25; 19:29; 21:92; 66:13
ligji nëse dikush e prish	24:3 ; 14:16-17
tradhtia bashkëshortore: dëshmitë	24:5; 24:7, 14
tradhtia bashkëshortore: e ndaluar	17:33; 6:152; 24:4; 25:69; 60:13
tradhtia bashkëshortore: parandalimi	24:31-32; 53:33
tradhtia bashkëshortore: dënimi	24:3; 4:16-17; 4:26; 24:5
tradhtia bashkëshortore: namazi të ndalon prej saj	29:46
<b>Ndërmjetësimi:</b> <i>shefa'at</i> ; duke e lënë Allahun, s'ka ndërmjetësim tjetër	32:5; 39:45

» <b>Ndërmjetësimi:</b> Ditën e Gjykimit nuk hyn në punë asnjë miqësi a ndërmjetësim	2:255, 49, 124; 74:49
asnjë nga zotat e rremë nuk mund të jetë ndërmjetës	6:95; 30:14
bëhet vetëm me lejen e Zotit	10:4; 78:39
Pse Profetit do t'i jepet leje për të bërë ndërmjetësim?	53:10
kërkoni mjetin (për t'u afruar) drejt Tij ( <i>uesile</i> )	5:36
nxitje për të bërë ndërmjetësim në punët pozitive në këtë botë	4:86
referenca të tjera	2:49; 2:124, 255, 256; 4:86; 6:52; 10:4; 10:19; 19:88; 20:110; 21:29; 26:101; 34:24; 39:45; 43:87; 53:27; 74:49
<b>Ndëshkimi:</b> Allahu nuk bën padrejtësi në ndëshkim	29:22; 10:28; 11:118; 16:127
ndëshkime të ndryshme prej Allahut	29:41
Allahu e vonon atë	10:12; 6:60; 35:46; 89:27; 22:66
shmangia e tij	5:40; 7:157; 10:99
me bomba, mjete luftar	36:30; 36:50-51, 54
më i shumë për udhëheqësit	11:21
për kurvërinë	24:3; 4:26; 4:16
për ata që bëjnë trazira në tokë	5:34
për ata që mohojnë	29:41
për vrasje	2:179-180; 4:93-94
për vjedhje	5:39
për shpifje	24:5-6, 7-10
për shkelje të tjera	4:17
në jetën e përtejme	11:104
llojet e ndëshkimit	6:66; 10:14; 22:10; 24:6; 29:41; 32:22
të mbrojtur nga ndëshkimi	8:34; 23:33; 24:53
pas paralajmërimit	26:209; 17:16; 20:135; 23:77-78; 28:60
<b>Nebukadnezar:</b>	2:260; 17:6; 21:86; 85:5
<b>Nefsi:</b> <i>nefsi</i> , vetvetja	89:28-29; 2:55, 73, 131; 3:31; 4:85; 6:94, 131; 12:54; 15:37; 75:3 Shih edhe: <b>Shpirti</b>
<b>Nemrudi:</b>	2:259; 21:68-70
<b>Nesibejni:</b> hebrenjtë e Nesibejnit	46:30-33; 72:2
<b>Nesija:</b> një zakon para Islamit	9:37

<b>Ngjyrat:</b> ngjyra të ndryshme	35:28-29; 2:70; 16:14, 70; 30:23; 39:22; 55:65
“ngjyra” e Allahut	2:139
<b>Ninevah:</b>	10:99; 30:5; 37:140-141; 46:30
<b>Nofkat:</b>	49:12
<b>Nuhu<sup>as</sup>:</b>	7:60; 11:26-27; 17:4; 23:24; 29:15; 37:80
historia e tij	7:60-65; 3:34; 10:72-74; 11:26-49; 23:24-31; 25:38; 26:106-121; 37:76-82; 51:47; 54:10-17; 71:2-29
arka e tij	11:38-45; 23:28-30; 26:120; 54:14-15
lutja e tij	71:27-29; 11:35-37, 46; 21:77; 23:27, 30; 26:119; 37:76-77; 54:11
koha e tij si profet	29:15
përqeshja nga njerëzit	23:25-27; 7:65; 10:74; 22:43; 25:38; 26:106, 118; 38:13; 40:6; 50:13; 54:10; 71:22
gruaja e tij	66:11
i biri	11:46-48; 11:43-44
mallkimi i tij	71:6-29; 11:37
përmbytja	11:41-45; 11:49; 23:28; 54:12-15; 69:12
pasardhësit e tij	6:85-87; 37:76-78
<b>Njerëzimi:</b> njerëzimi dhe themeli i dhembshurisë mes tyre	4:2; 49:14
dhe Allahu	49:14; 1:4; 2:22; 10:93; 12:39; 13:7, 32; 14:53; 17:71; 22:19; 27:74; 30:31; 35:3; 40:58, 62; 45:27; 57:26; 114:2-4
dhe Profeti <sup>savs</sup>	7:159; 4:80, 171; 6:91; 10:3; 16:45; 18:7; 21:108; 22:50; 25:2; 28:88; 34:29; 42:16, 53
dhe Meka	2:126; 3:97; 5:98
dhe Kurani	10:58; 14:2; 17:90, 107; 18:55; 25:2; 59:22; 29:44; 39:28, 42; 45:21
dhe <i>umeti</i>	2:214; 3:111; 5:33; 10:20; 11:119; 16:90; 23:53; 43:34
<b>Njeriu:</b> vendosja në Tokë	2:30; 7:11; 15:20-21; 20:56; 78:7-17; 80:19-23
çdo gjë e qiejve dhe e Tokës është në shërbim të tij	22:66; 31:21; 45:13-14; 15:30; 7:12; 17:62; 18:51; 20:117
ishte asgjë përpara se të krijohet	19:68
fazat e para të jetës në Tokë	15:29-30
u krijua në etapa	71:14-19
u krijua prej uji	24:46; 21:31; 25:55; 77:21
u krijua nga një esencë prej balte	23:13
u krijua prej balte ( <i>tin</i> )	6:3; 32:8; 38:72; 7:13; 33:77; 17:62

» <b>Njeriu:</b> u krijua prej dheu ( <i>turab</i> )	3:60; 22:6; 30:21; 35:12; 40:68; 18:38
u krijua prej një balte të thatë kumbuese, prej baltës së tharmuar	15:27-29, 34
u krijua prej një balte të thatë kumbuese porsì poçe	55:15
u rrit porsì bimët	71:18
rolì i klorofilit në krijimin e njeriut	f. 199
një periudhë e hershme e zhvillimit të njeriut	76:2; f. 1079
u krijua prej një shpirti të vetëm	4:2; 6:99; 39:7
u krijua prej një mashkulli dhe femre	49:14
u krijua prej një uji që përhidhet	86:7
u krijua prej sperme	16:5; 18:38; 22:6; 23:14-15; 35:12; 40:68; 53:47; 56:59; 75:38; 76:3; 77:21-24; 80:20; 86:7-8
u krijua prej sperme të përbërë	76:3
u krijua prej ngjizje gjaku	96:3
u krijua prej barkut të nënës	16:79
faza të ndryshme të krijimit në mitrën e nënës	22:6; 23:13-15; 31:29
krijimi i tij nën tri errësira	39:7
etapa e fundit e krijimit në mitër: <i>një krijesë tjetër</i>	23:15
çifti është bërë prej shpirtit të parë	4:2
krijimi: meshkuj e femra	53:46
tri etapa të krijimit të njeriut: <i>krijimi, drejtimi, përsosmëria</i>	82:8
mësoi të mirën dhe të keqen përmes shpalljes Hyjnore	91:9
i gjithë evoluimi shpirtëror i njeriut	95:2-7; f. 1152
fillimi i zhvillimit të njeriut me të nxënit përmes penës	f. 1154
shembulli i majmunit për njeriun, për të treguar gjendjen e tij të ulët	2:66
zhvillimi i shqisave të tij gjatë evolucionit	23:79
sekretet e krijimit janë të koduara në ADN	f. 965
edhe galaktikat ndikojnë te njeriu	f. 694
po të mos kishte kafshë të tjera, njeriu do të asgjësohej	16:62
çdo njeri lind me natyrën e pastër	30:31

» <b>Njeriu:</b> në fillim kishte një gjuhë dhe një ngjyrë	30:23
është një mikrokozmos	878
ka rojtarë para e mbrapa (sistemi imunitar)	13:12
mund të arrijë zhvillimin madhështor	33:73; 53:40; 64:3; 87:3-4; 95:1-9 Shih edhe: <b>Spiritualizmi</b>
nuk ngarkohet përtej fuqisë së tij	2:287; 2:234; 6:165; 7:43; 23:63; 65:8
i është dhënë vullneti i lirë	6:108; 6:150; 41:12, 41; 76:4; 90:11; 91:9
do të mbajë përgjegjësi	58:7; 6:165; 17:15, 72; 24:25; 36:66; 41:21; 69:20, 26; 75:15
qëllimi i krijimit të tij	51:57; 1:5; 2:132; 4:126; 6:166; 90:5-6
është krijuar i ngutshëm	21:38
është shumë lakmitar	70:20
është shumë koprrac	17:101
është shumë mosmirënjohës	17:68
është grindavec	18:55; 16:5; 36:78; 19:98; 2:63; 2:205
është krijuar i dobët	4:29
është shumë i vetëdijshëm për veten e tij	75:15
nuk do të ketë asgjë përveç përpjekjes së tij; nuk i shpëton dot përpjekjes	53:40; 90:5; 30:54
nuk lodhet duke u lutur për të mirën dhe, po e preku e keqja, bëhet tejet i zhgënjyer	41:50
kur është në vështirësi, lutet shumë	10:13; 39:9; 39:50; 41:50
largohet pasi begatohet nga Allahu	41:52
thërret të keqen sikur thërret të mirën	17:12
tri nivelet e njerëzve	35:33
natyra e njeriut e krijuar nga Allahu	30:31
natyra e tij	30:31; 4:29; 10:13; 11:10-11; 14:35; 16:5; 17:12, 68-70, 101; 18:55; 21:38; 22:6, 67; 23:78-79; 25:51; 30:37; 31:7-8, 22; 33:73; 34:32; 36:78-79; 38:61; 39:50; 40:11; 41:50-52; 42:49; 43:16; 57:9; 70:20-22; 75:21; 80:18; 89:16-21; 90:5; 91:8-9; 95:5; 96:7-8; 100:7, 9; 103:3-4
nuk është i pavdekshëm	21:35-36; 2:29; 3:186; 20:56; 22:8; 23:101; 29:58; 36:69, 79; 37:59-60; 40:12; 50:19-20; 55:27-28; 58:7; 71:19
përsosmëria në të	55:4; 15:30; 32:10; 38:73; 95:5
i pajisur me të gjitha aftësitë e duhura	32:10; 16:79; 46:27; 87:4
Kurani si udhëzim për të	39:42

» <b>Njeriu:</b> sprovohet	2:156-157; 29:4; 2:103; 3:187; 6:166; 8:29; 10:86; 14:7; 21:36, 112; 22:12, 54; 25:29; 39:50; 54:28; 64:16; 94:6-7; 18:8
Zoti ka lënë në gjenezën e njeriut që ai nuk mund ta mohojë Zotin	7:173; 57:9
është i lirë të veprojë si të dojë	41:41
Allahu e nderoi atë	17:71
Allahu e krijoi dhe ia mësoi mënyrën e të shprehurit	55:4-5
Allahu nuk e ngarkon atë përtej kapacitetit të tij	23:63; 65:8; 2:234;
mëkëmbës në tokë	2:31; 6:166; 17:71; 38:27
Allahu është i Plotfuqishëm të krijojë një krijesë më të mirë se njeriu	70:41-42
degradimi i tij	95:6; 2:66; 8:23; 8:56
<b>Ora:</b> koha, kiameti, <i>sa'ah</i>	25:12; 6:32, 41; 7:188; 12:108; 15:86; 16:78; 18:22; 20:16; 21:50; 22:2, 8, 56; 30:13, 56; 31:35; 33:64; 34:4; 40:60; 41:48, 51; 42:18-19; 43:62, 67, 86; 45:28, 33; 47:19; 54:2, 47; 79:43, 44; 42:8
ora e premtuar	46:36; 7:35; 9:117; 10:46; 16:62; 30:56; 16:78
<b>Orbita:</b>	36:41; 21:34
<b>Padukshmja (e):</b> Allahu ua tregon të Dërguarve	72:27; 3:180; 3:45; 11:50; 12:103
dija e së padukshmes; e di vetëm Allahu	10:21; 2:34; 6:60, 74; 31:35; Shih: <b>Dija</b>
të Dërguarit dinë vetëm atë pjesë të së padukshmes që ua mëson Allahu	10:21; 6:51; 7:189; 11:32; 3:45
besimtarët besojnë në të padukshmen	2:4
Allahu ua premtoi robërve të Tij xhenetin e së padukshmes	19:62
panteizëm, d.m.th. besimi se gjithçka është Zoti, ose pjesë e Tij	6:4; 7:55; 42:12
<b>Paqja:</b> animi nga paqja	8:62; 47:36; 49:10-12
<b>Pastër (e):</b> e pastër ( <i>tajjib</i> )	3:39, 180; 8:38; 9:72; 10:23; 14:25; 16:33, 98; 24:62; 61:13
gjërat e pastra	5:101; 2:58, 173, 268; 4:3, 44, 161; 5:5-6, 88; 7:33, 158, 161; 8:27, 70; 10:94; 16:73; 17:71; 20:82; 22:25; 24:27; 35:11; 45:17; 46:21
ushqimi i pastër dhe i shëndetshëm	2:169; 2:58, 173; 5:89; 7:161; 16:115; 23:52; 34:16
<b>Pastër (i):</b>	3:39; 4:44, 161; 5:7; 16:98; 22:25; 37:85; 40:65; 45:17; 61:13; 98:3

» <b>Pastër (i):</b> Allahu i bën të pastër njerëzit	4:50; 24:22
pije; uji	25:49; 67:31; 76:22; 83:26
ushqimi	2:173; 5:5; 6:119; 23:52
partnerët; bashkëshortët	2:26; 4:58; 52:25
besimtarët	16:33; 20:77; 24:36; 27:57
<b>Pasuria:</b> nuk sjell dobi	104:3-5; 3:11, 15; 26:89; 34:35-38; 58:18; 69:29; 92:12; 102:2-9; 111:3
besimtarit i sjell dobi	92:18-22; 2:246, 262, 273, 275; 4:96; 71:13
dashuria për të, sprovë	89:21; 2:156; 9:24, 55, 69, 81, 86; 18:47; 19:78; 20:132; 23:56-57; 26:89; 34:36; 63:10; 64:16-17; 68:15-34; 70:19; 71:22; 100:9; 102:2-3; 104:2-5
bashkëpjesëtarë të saj	51:20; 2:216; 16:72; 24:23, 34; 70:25-26
shpenzohet në rrugën e Allahut	2:262-268; 9:41, 44, 88, 103; 47:37; 61:12; 92:18-22
porosi për të mos e shpërdorur atë	17:27-31
shpenzime të palejuara	2:189; 4:162; 4:39
dhe fëmijët janë sprovë	8:29
gllabërimi i pasurisë së tjetrit	2:189; 4:7, 30
e jetimëve	4:6-7
<b>Pema:</b> nëse pemët do të bëheshin pena	31:28; 18:110
pema e mallkuar	17:61
pema e mirë dhe pema e keqe	14:25-27
pema e <i>zekkumit</i>	37:63-67; 14:27; 44:44-5; 56:53-54
pema e ndaluar	2:36; 7:20-21, 23; 20:121
pema e “përjetësisë”	20:121
pema e gjelbëruar	36:81
hidja	53:15; 34:17; 53:17; 56:29
pema ku u bë betimi	48:19
<b>Pendesa:</b>	9:112; 3:90; 11:91; 25:71-72; 66:9
Allahu e pranon	4:18-19; 39:54; 2:161; 9:5, 104; 16:120; 42:26; 4:111; 5:40; 6:55; 25:71-72
pendesa në kohën e vdekjes ose të ndëshkimit, nuk pranohet	4:19; 39:55-60
pendesa e sinqertë ( <i>teubeten nasuha</i> )	66:9
Zoti ia pranon kujt të dojë	9:27
pendesëbërësve Allahu ua kthen të këqijat në të mira	25:71

» <b>Pendesa:</b> pendesëbërësit do të hyjnë në xhenet	19:61
pendesa e tre sahabëve	9:118
e apostatëve	3:91
<b>Peng:</b>	74:39; 2:284; 3:77; 12:81; 43:51; 52:22; 59:16
<b>Perëndimi:</b>	Shih: <b>Lindja e Perëndimi</b>
<b>Perimet:</b> perime, tranguj, drithëra, thjerrëza dhe qepë	2:62
kungull	37:147
<b>Persekutimi:</b>	2:191-94; 2:215, 218; 3:187; 8:40; 9:5, 128; 23:95; 29:11; 33:22; 85:9
<b>Peshorja:</b>	42:18; 57:26; 17:36; 6:153; 7:86; 11:85-86; 26:182-183; 55:10;
peshore në qiej dhe në tokë	15:20; 55:8-9;
në Ditën e Gjykimit	23:103-4; 7:9-10; 21:48; 101:7-10
<b>Përcimi i mesazhit:</b> thirrje drejt rrugës së Zotit; predikim, <i>davet</i> ; <i>teblig</i>	16:126; 42:49; 7:69, 80, 94; 11:58; 46:24; 53:11
duhet me urtësi	16:126; 3:115; 3:188; 22:68; 23:74; 26:215; 28:88; 29:47; 41:34-36; 51:56; 62:3
me argumentin më të mirë	29:47
jo me imponim	9:6; 2:257; 5:106; 20:45; 25:53, 58; 71:10
largo të keqen me të mirën	13:23; 5:106; 16:126; 23:97; 28:55; 41:35; 103:4;
<b>Përgojimi:</b>	49:13; 68:12; 104:2 Shih edhe: <b>Morali</b>
<b>Përjetësia:</b> shtëpia e përjetësisë	44:57; 50:35
i takon vetëm Allahut	55:27-28; 2:157
<b>Përkujtimi (tesbih):</b> përkujto Allahun mëngjeseve e mbrëmjeve	20:131; 40:56; 50:40; 3:42; 33:43; 48:10
kuptimi leksikor; pse themi <i>subhanAllah</i> ?	57:2
“çdo gjë e lartëson Zotin”, kuptimi	64:2; 57:2; 13:16
përkujtimi më i madh i Allahut është bërë nga Profeti <sup>savs</sup>	f. 1014
gjithçka e këtij universi e përkujton Allahun	59:25; 57:2; 61:2; 17:45; 62:2; 64:2
engjëjt e përkujtojnë Allahun	2:31; 21:21; 39:76; 13:14; 40:8; 42:6
malet e përkujtojnë Allahun	21:80; 38:19
zogjtë e përkujtojnë Allahun	24:42



» <b>Përkujtimi (tesbih):</b> Junusi <sup>as</sup> po të mos e kishte përkujtuar Allahun, do të mbetej në barkun e peshkut përgjithmonë	37:144-145
vetëtima dhe bubullima e përkujton Allahun	13:14
referenca të tjera për këtë temë	56:75; 20:131; 2:31; 3:42, 114, 192; 6:2; 7:207; 13:14, 16; 15:99; 17:45; 18:2; 19:12, 59; 21:21, 23; 22:78; 24:37, 42; 25:2, 65; 32:16; 34:2; 35:2; 37:167; 38:19; 39:10, 76; 41:38-39; 48:10; 50:40-41; 55:7; 59:25; 61:2; 62:2; 64:2; 87:2; 96:20; 110:4
i shenjtë është Allahu ( <i>subhan</i> )	12:109; 2:33, 117; 3:192; 4:172; 5:117; 6:101; 7:144; 9:31; 10:11, 19, 69; 16:2, 58; 17:2, 44, 94, 109; 19:36; 21:23, 27, 88; 23:92; 24:17; 25:19; 27:9; 28:69; 30:18, 41; 34:42; 36:37, 84; 37:160, 181; 39:5, 68; 43:83; 52:44; 59:24; 68:30
<b>Përhëndetjet:</b>	4:87; 4:95; 10:11; 14:24; 19:63; 24:62; 25:76; 33:45; 36:59; 58:9
<b>Pllaka e ruajtur:</b>	85:22-23
<b>Poeti:</b>	36:70; 2:2, 16, 74; 4:25; 11:47; 17:82; 21:6, 11; 26:225-228; 37:37; 52:31-32; 69:40-42
<b>Populli:</b> i Hixhrit	15:81
i Medjenit	11:85; 7:86
i Tubbas	44:38; 50:15
i pusit	25:39; 50:13;
i pyjeve	15:79; 26:177; 38:14; 50:15
<b>Predikimi:</b>	<b>Shih: Përçimi i mesazhit</b>
<b>Premtimi:</b> Allahu e mban premtimin e tij	3:195; 3:10; 4:123; 6:135; 7:45; 10:5, 56; 11:46; 14:48; 16:39; 17:109; 18:22, 99; 21:10; 22:48; 28:14; 30:61; 31:10, 34; 35:6; 40:56, 78; 43:43; 45:33; 46:18; 51:6; 77:8
pritja e përmbushjes së premtimit Hyjnor	10:49; 21:39; 23:94; 27:72; 34:30; 36:49; 40:9; 43:50; 67:26
përmbushe premtimin tënd	2:178
i Allahut	24:56; 2:269; 3:153; 4:96; 5:10; 8:8; 9:72, 111; 13:36; 18:49; 19:62, 88; 21:102, 104-105; 23:36; 25:16-17; 28:62; 30:7; 33:23; 34:31; 38:54; 39:75; 41:31; 46:17; 47:16; 48:22, 30; 50:33; 51:23; 57:11; 85:3
ndaj Ibrahimit, ndaj Jusufit	9:114; 12:67

» <b>Premtimi:</b> ndaj mohuesve, ndaj hipokritëve	2:81; 7:136; 9:68, 77; 11:66; 13:32; 14:45; 15:44; 19:79; 21:98, 110; 22:73; 23:84; 26:207; 27:69; 33:13; 35:41; 36:53; 36:64; 43:84; 51:61; 54:47; 70:43, 45; 72:25-26; 73:19
ndaj Musait	2:52; 7:135, 143; 20:87-88
ndaj Shejtanit	2:269; 4:121; 14:23
si paralajmërim	14:15; 20:114; 50:15, 21, 29, 46
<b>Prindërit:</b>	17:24-5; 2:84; 4:37; 6:152; 14:42; 27:20; 29:9; 31:15-16; 46:16, 18; 71:29
<b>Privatësia:</b>	24:59-60; 33:54
<b>Profecitë:</b> mund të shtyhen ose të anulohen	11:34; 10:47, 99; 40:78; 43:50-51; 44:16
përmbushja e tyre	6:68; 6:116; 13:41; 40:78-79
si sprovë kanë ndonjë pjesë të paqartë	30:5
<b>Profecitë e Kuranit:</b> për betejat	30:5; 8:43; 38:12; 48:22; 52:7; 54:46-49; 79:7-8
për kanalet që bashkojnë detet; për kanalin Suez e Panama	55:20-23; 81:7; 82:4; 25:54
për mohuesit; hipokritët	8:37; 9:82; 27:83
për Jexhuxhët dhe Mexhuxhët	33:95-100; 21:97-98; 18:48, 95, 100
për Profetin e Shenjtë <sup>savs</sup>	28:86; 2:41-42, 90; 5:48; 10:72; 17:2, 61, 81; 38:12; 46:11-13; 47:14; 54:7-9; 81:24; 89:2-3; 90:5; 92:2-3; 94:5
për Kuranin e Shenjtë	15:10; 3:8; 2:90, 102; 13:32; 26:197
për Orën	22:2-3; 54:2
për Islamin	58:22; 30:3-5; 48:29-30; 32:6; 61:10; 81:1-30; 2:116; 8:61; 9:33; 12:103; 16:78; 17:2; 19:41; 22:27; 33:23; 41:54; 43:90; 53:2; 56:4; 60:8; 90:2-3; 93:2-3; 94:6-7; 99:2-7
për judenjtë (hebrenjtë)	61:15; 3:113; 7:168; 17:8, 105
për Qabenë	5:98; 5:96; 22:27-28
për epokën që quhet <i>e mëvonshme (akharine)</i>	62:4-6; 81:2-19; 21:97; 61:10; 16:9; 17:59, 105; 36:42-43; 77:11-12; 82:2-5; 84:2-5; 99:2-9; 111:4; 104:2-10; 114:2-7 Shih edhe: <b>Mesihu i Premtuar</b>
për Mekën	17:81; 2:152; 6:116
për krimbin e tokës ( <i>dabbetul-ard</i> )	27:83
për Mesihun e Premtuar <sup>as</sup>	62:3-6; 61:10; 32:6; 81:1-19; 85:2-5 Shih edhe: <b>Mesihu i Premtuar</b>
për Palestinën	21:106-107
për romakët (bizantinët)	30:3-7

» <b>Profecitë e Kuranit:</b> për të krishterët që do të kenë dy periudha prosperiteti; dhe pas kësaj, nëse do të jenë mosmirënjohës, mund të kenë ndëshkim të pashembullt	5:115
për luftëra; tërmete	104:2-10; 22:2-3; 18:48; 55:32; 69:2-4; 101:2-10; 111:2
nuk përmbushen të gjitha profecitë gjatë jetës së Profetit	10:47; 13:41; 40:78
ngjarjet e përmendura në Kuran përbëjnë edhe profeci	18:61
për Hixhretin dhe kthimin në Mekë	28:86; 90:3; 89:2-6
për fitoren në Betejën e Hendekut	33:23; 38:12; 54:46
për fitoret e muslimanëve	33:28
për ardhjen e dytë të Profetit	62:4
muslimanët do t'i ndiqnin hadithet, duke e braktisur Kuranin	45:7; 25:31
për globalizmin	61:10; 81:1-30
për zbulime të reja	99:3-9; 81:2-19; 21:97
për mjete të reja transporti	81:5-6; 36:42-43; 16:9; 55:25
për hapjen e parqeve zoologjike	81:6
e gjithë bota do të bashkohet, me rrjet komunikimi, me hapjen e rrugëve ose me lehtësinë e udhëtimeve	81:8; 61:10
për inxhinierinë gjenetike	4:120
për zhvillimin e shkencës së astronomisë	81:12; 55:38
se njeriu do të mësojë për më shumë toka	84:4; 55:18
se njeriu do të tentojë të vëzhgojë përtej galaktikës	55:34
për zhvillimin e shkencave të tokës	84:4-6; 99:3
do të studiohen sekretet që janë në varre	82:5
do të ndërtohen anije porsiale	55:25; 42:33
për lundrimin edhe me anije nëndetëse	110:4
për publikimin masiv të librave	81:11; 52:3
për hapjen e gjykatave	81:9-10
për superfuqitë që do të përdorin parimin "përçaj e sundo"	113:5
qielli do të lëshojë zjarr	55:36
për luftërat atomike	104:2-10; 44:11
njerëzit dhe jashtëtokësorët do të kenë kontakt	42:30

<b>Profetëria:</b> dhuratë dhe bekim prej Zotit	6:90; 29:28; 45:17; 57:27
Zoti ia jep atij që ka dritë në shpirtin e tij	24:36
Allahu e di më së miri se kujt t'ia japë profetërinë	6:125
është bekimi i Allahut, që Ai ia jep kujt të dojë	62:5
llojet e saj	6:90; 2:254; 4:70; 17:16; 4:65; 5:45
çdo profet është edhe i dërguar dhe anasjelltas	2:254; 19:55
vazhdimësia e saj; profetëria në Islam	7:36; 1:7; 4:70; 22:76; 33:41; 33:8; 3:82; 40:35
pretenduesit e rremë të saj; profeti i rremë dhe fati i tij	20:62; 40:29; 69:45-48
funksionet e saj	23:53; 2:214, 254; 5:45, 100; 6:49; 10:73; 19:52; 20:135; 21:93; 25:11; 28:48; 30:42; 33:40; 36:15
<b>Profetët:</b>	për një Profet të caktuar, shih tek emri i tij: <b>Ademi<sup>as</sup>, Idrisi<sup>as</sup>, Nuhu<sup>as</sup>, Salihu<sup>as</sup>, Hudi<sup>as</sup>, Ibrahim<sup>as</sup>, Luti<sup>as</sup>, Ismaili<sup>as</sup>, Is'haku<sup>as</sup>, Jakubi<sup>as</sup>, Jusufi<sup>as</sup>, Ejubi<sup>as</sup>, Shuajbi<sup>as</sup>, Musai<sup>as</sup>, Haruni<sup>as</sup>, Davudi<sup>as</sup>, Sulejmani<sup>as</sup>, Iljasi<sup>as</sup>, Eljesai<sup>as</sup>, Junusi<sup>as</sup>, Dhul-kifli<sup>as</sup>, Zekerijai<sup>as</sup>, Jahjai<sup>as</sup>, Isai<sup>as</sup>, Muhammedi<sup>savs</sup></b>
i zgjedh Allahu	3:180; 22:76
janë tallur, janë kundërshtuar, janë quajtur gënjeshtarë, të çmendur, magjistare, etj.	51:53-54; 2:88; 3:185; 6:11; 7:93, 110; 14:14; 15:7, 12, 81; 18:107; 20:64; 25:38; 26:28, 35, 124, 142, 154, 161, 177, 186; 34:9; 37:37; 38:5; 40:25; 41:15; 43:48, 50; 44:15; 51:40; 54:10; 68:52
si engjëj; si njerëz	11:70; 6:62; 10:22; 11:78, 82; 12:51; 19:20; 21:9; 22:76; 25:9, 21; 29:32, 34; 35:2
janë të pastër; nuk kanë asnjë grimë pandershmerie	3:162; 24:36; 12:34
kanë respekt të pashembullt ndaj Allahut	11:46
besëlidhja e Profetëve me Allahun	3:82; 33:8
familja e tyre e vërtetë është ajo që ka lidhje shpirtërore	11:47
kriteri i pagabueshëm për të testuar vërtetësinë e Profetit	10:17
dallimi mes Profetëve dhe fallxhorëve	72:27-28
ai që refuzon Profetin e kohës së tij, është sikur të ketë refuzuar të gjithë Profetët	26:106; 54:23

» <b>Profetët:</b> Profeti nuk bën vetëm deklaratën, por tregon edhe dëshminë e Zotit	13:44
Kurani ua dallon cilësitë Profetëve, duke i liruuar edhe nga akuzat që ua kanë ngjitur	6:85-87
nuk ushqejnë në zemër asnjë dëshirë të fshehtë për lidërsnip	38:70
Profeti ndez shkëndijën e njëshmërisë së Zotit në zemrën e njeriut	4:153; 23:53
ata që sollën ligje (sheriata) dhe ata që nuk sollën ligje të reja	2:254
përçuan shpalljet	7:204; 6:51; 18:111; 21:109
diskriminimi i tyre	2:254; 4:151-152; 17:56
dhe ndihma hyjnore	40:52; 10:104; 30:48; 58:22
u është dhënë siguri	72:28-29
Profeti <sup>savs</sup> si një i dërguar	3:145; 2:109, 286; 4:66, 70, 137, 164; 7:158-159; 33:22, 41; 36:15
si mëshirë për njerëzimin	44:6-7
mesazhi i tyre	3:65; 7:60; 11:3, 4, 53; 16:37; 98:6
bindja ndaj tyre	4:65
përpara se të ndëshkojë një popull, Allahu i dërgon profet	17:16
janë dërguar burra	12:110; 13:39; 16:44; 21:8
tek të gjithë popujt	10:48; 3:34-35; 6:86-88; 13:8; 14:10; 16:37, 85; 17:6; 23:45; 35:25; 57:28
njëqind e njëzet e katër mijë Profetë	4:165
Profeti Muhammed është Vula e Profetëve	33:41
çdo profet kundërshtohet dhe përqeshet	36:31; 21:42; 43:8; 23:45
përfundimisht ata triumfojnë	58:22
disa nuk janë përmendur në Kuran	4:165; 5:25; 40:79
japin lajme të mira dhe paralajmërimë	5:20; 4:166; 11:121
do të merren në pyetje	5:110; 5:117
Allahu i zgjedh profetët e Tij	6:125; 4:70; 14:12; 16:3; 19:52; 22:76
Allahu i ndihmon ata	40:52; 37:172-173
dhe të Dërguarit	19:52; 19:55
janë udhëheqës	36:2; 14:12
janë të vdekshëm, si të gjithë njerëzit	21:8-9; 13:39; 14:11-12; 17:94; 18:111; 19:59; 21:35; 25:8, 21
besimi në to	4:151; 2:137, 286; 3:85; 4:153
duhet t'u tregoni respekt	2:105; 4:47

» <b>Profetët:</b> armiqtë e tyre	6:113; 25:32; 58:22
nuk janë të pandershëm	69:45-48; 3:162, 185; 6:22; 10:18, 83; 21:30; 34:46
i frikësohen vetëm Allahut	33:40
të përmendur në Kuran	4:164-5; 40:79
bindja ndaj tyre	4:65; 26:109
kundërshtimi ndaj tyre	10:20; 21:42; 22:53; 23:45; 25:32; 26:154; 34:35, 44; 41:44; 51:53-54; 54:24
janë dërguar tek të gjithë popujt	35:25; 10:48; 13:8; 14:10; 16:37, 85; 17:6;
nuk mëkatojnë	21:28; 6:163
vrasja e tyre	2:62; 2:88, 92; 3:22, 113; 4:156
superioriteti i disave	2:254; 6:87; 17:56; 27:16
sprovat e tyre	2:215; 6:113; 25:32; 36:31; 43:8
selam mbi ta	37:182
<b>Qabeja:</b> lashtësia e saj	2:128; 3:97
fitore e premtuar	48:25-28
i përket vetëm Allahut	9:3; 8:35-36; 9:18-19, 28; 22:27
kibleja	2:143; 2:145-146, 150-51
për gjithë njerëzimin	3:97-98; 5:98
Qabeja	17:2; 52:5
u rindërtua	2:128; 22:27, 30
vend i paqes dhe i sigurisë	2:126; 5:3; 29:68; 105:2-6
emra të tjerë të Qabesë (shtëpia e lashtë, shtëpia e shenjtë etj.)	22:30; 22:34; 17:2; 2:126, 128, 159; 5:3, 98; 8:36; 14:38; 22:27, 30; 28:58; 106:4-5; 52:5
qetësia e zemrës, qetësia shpirtërore	48:5; 2:249; 3:155; 9:26, 40, 103; 23:51; 48:19, 27
<b>Qumështi:</b>	47:16; 16:67
<b>Ramazani:</b> për të cilin u zbrit Kurani	2:186 Shih edhe: <b>Agjërimi</b> , dhe <b>Nata e Kadrit</b>
<i>itikafi</i>	2:188
<b>Ringjallja e të vdekurve:</b> e bën vetëm Allahu	75:41; 36:13; 42:10; 2:259; 3:157; 7:159; 10:57; 15:24; 22:7; 50:44; 53:45 Shihni: <b>Ahireti</b> , <b>Xheneti</b> , <b>Xhehenemi</b>
i vdekuri nuk kthehet më në këtë botë, andaj, ringjallja në këtë botë është në kuptimin shpirtëror të fjalës	21:96; 36:32; 39:43
ç'domethënë ringjallja e të vdekurit në këtë botë?	6:123
pyetja e Ibrahimit <sup>as</sup> për ringjalljen e të vdekurve	2:261

» <b>Ringjallja e të vdekurve:</b> Profeti Muhammed <sup>savs</sup> ringjalli “të vdekurit”; kuptimi	8:25
Isai <sup>as</sup> ringjalli “të vdekurit”; kuptimi	3:50; 5:111
ringjallja e të vdekurit përmes argumentit të qartë	8:43
si të ringjallesh në një jetë të pastër?	16:98
ajetet që flet për ringjalljen e një njeriu pas 100 vitesh dhe kuptimi i tij	2:260
<b>Robërit e Allahut:</b>	25:64-77; 1:7; 2:91, 187, 208; 3:16, 21, 183; 4:173; 5:119; 6:89; 9:104; 10:108; 12:25; 14:12, 32; 15:43; 16:3; 17:6, 54, 66; 18:103; 19:3, 31, 64; 20:78; 21:106; 23:110; 25:18; 26:53; 28:83; 29:57, 63; 35:29, 33; 36:31; 37:75, 82, 161; 38:18, 46; 39:11, 54; 42:24, 28; 43:60; 50:12; 66:11; 89:30
çfarë do të thotë të jesh rob i Allahut?	1:5
Profeti Muhammed, rob i Allahut ( <i>abdullah</i> )	2:24; 8:42; 17:2; 18:2; 25:2; 39:37; 53:11; 57:10; 72:20
<b>Robërit e luftës:</b> martesë me ta	24:33
këshillohet të lirohen	47:5; 4:4; 24:34
mbajtja e tyre	8:68-69; 47:5
trajtimi i tyre	47:5
<b>Ryshfeti:</b> mitëmarrje	2:189
<b>Rruga e drejtë:</b> <i>siratal-mustakim</i>	1:6; 2:109, 171, 214, 273; 3:52, 102; 4:68-69, 176; 5:17; 6:40, 88, 154, 162; 10:26; 11:57; 14:2-3; 16:77, 122; 19:37, 44; 20:136; 22:55; 23:74-5; 24:47; 36:5, 62; 37:119; 42:53; 43:44, 62, 65; 46:31; 48:3, 21; 67:23
<b>Sahabët e Profetit:</b>	33:24; 5:120; 9:100; 46:36; 48:27, 30; 58:23
Ebu Bekri <sup>ra</sup>	9:40
Zejd <sup>ra</sup>	33:37-39
Aishja <sup>ra</sup>	24:12-19
vlera e sahabëve të Profetit	33:24; 58:23
<b>Salihu<sup>as</sup>:</b> Salihu <sup>as</sup> dhe populli themud	11:62-69; 7:74-80; 15:81-85; 26:142-159; 27:46-48; 41:14, 18; 51:44-46; 69:5-6; 91:12-15; Shih edhe: <b>Themudët</b>
deveja e tij	7:74
<b>Samiriu:</b>	20:96-98; 2:55; 37:11
<b>Sarah:</b> gruaja e Ibrahimit <sup>as</sup>	11:72-74; 2:130; 6:75
<b>Sektet:</b>	6:160; 6:66; 23:54; 40:84; 9:30, 100; 30:31, 33; 72:12

<b>Selam:</b> përshëndetje	39:74; 4:95; 7:47; 10:11, 26; 11:70; 13:25; 14:24; 16:33; 19:16, 34, 48, 63; 25:64, 76; 28:56; 33:45; 36:59; 37:80, 110, 121, 131, 182; 43:90; 51:26; 56:27, 92
paqe	36:59; 15:46-47; 5:17; 6:55, 128; 10:26; 20:48; 21:70; 27:60; 50:35; 97:6;
<b>Selsebil:</b> burim në xhenet	76:19
<b>Sexhdeja:</b> ajetet ku lexuesi të bëjë sexhde	7:207; 13:16; 16:51; 17:110; 19:59; 22:19; 22:78; 25:61; 27:27; 32:16; 38:25; 41:39; 53:63; 84:22; 96:20
lutje që bëhet në sexhden e leximit të Kuranit	7:207
<b>Sëmundja:</b>	2:11; 2:220; 4:4; 5:53; 8:50; 9:125; 10:58; 20:98; 22:54; 24:51; 33:13, 33, 61; 38:42-43; 47:21, 30; 74:32
të sëmurë	26:81; 2:185-186, 197; 4:44; 9:91; 24:62; 48:18; 73:21
<b>Sihariqet:</b> lajme të mira	2:98; 16:90, 103; 27:3; 46:13
sihariqtar, përcjellës i lajmeve të mira	5:20; 2:120; 7:189; 11:3; 12:97; 34:29; 35:25; 41:4-5
lajme të mira për besimtarët, të sinqertët dhe ata që kanë druajtje ndaj Allahut	2:26; 2:156, 224; 9:112; 10:3, 65, 88; 17:10; 22:35, 38; 33:48; 36:12; 39:18; 41:31; 57:13; 61:14
lajme të mira për Profetët	3:40; 3:46; 15:54; 19:8, 20; 29:32; 37:102, 113; 51:29
“lajme të mira” për mohuesit	3:22; 4:139; 9:3, 34; 84:24-25
<b>Sinagoga:</b> mbrojtja e tyre	22:41
<b>Sklavëria:</b> heqja e saj	47:5; 24:34; 3:135; 33:51; 90:14; 4:4
Kurani e dënon; e lejon vetëm në kushte tejet të rënda	8:68
martesa me ta/to	2:222
<b>Skriptet:</b> <i>suhuf</i>	87:19-20; 2:42, 107, 160; 3:8, 82; 5:49; 6:115, 156; 10:38; 16:44-45, 85; 18:2-3; 20:134; 26:193-94, 197; 27:31; 28:50; 29:49; 35:26; 36:3, 13; 41:42; 42:16; 43:22; 46:5; 53:6, 37, 38; 54:18, 44; 74:53; 80:14; 98:3
dorëshkrimet	21:105
<b>Spiritualizmi:</b> ç'është adhurimi?	1:5; 15:100; 29:46
rruga e drejtë dhe qëndrueshmëria janë çelësi për suksesin	1:6
fazat e para të jetës shpirtërore	15:30
si ta lartësosh namazin?	2:4



» <b>Spiritualizmi:</b> kur i ngurtësohet zemra njeriut?	2:8
sprova e pastron njeriun ose i nxjerr në shesh ligësitë e tij; pse Zoti të sprovon?	2:11; 29:4; 2:156
edhe për adhurimin e Zotit, kemi nevojë për ndihmën e Tij	1:5
xhenetin e ndërton që këtu në këtë botë	2:26
pozita e lartë e njeriut është ajo kur ai e shkatërron djallin e tij	37:7-11
njeriu derisa nuk e arrin pastrimin shpirtëror, i përngjan ndonjë kafshe a krimbi	2:66
duhet të gjesh zgjidhje nëpërmjet pendesës, përpara se mëkatet e tua ta kenë përhapur helmin e tyre	2:82
nuk ka spiritualizëm pa druajtje	2:3
një nga objektivat themelore të të gjitha adhurimeve është ta arrish druajtjen (takvanë)	2:204
synimi duhet të jetë – “garoni në mirësi”	2:149
njeriu pa spiritualizëm digjet në lloj-lloj zjarresh	69:33; 2:202
paragjykimi, një nga pengesat kryesore që nuk të lejon ta njohësh të vërtetën	38:7
“vdisni përpara se t’ju vijë vdekja!” kuptimi	2:244
shëndeti mendor dhe fizik është i rëndësishëm për lidrshipin	2:249
si përgatit Profeti mësues të tjerë për ringjalljen e popullit	2:261
njeriu zemërpastër	37:85
ai që e ka të papastër gjuhën ose ndonjë gjymtyrë tjetër të tij, edhe zemrën e ka të papastër	2:284
katër faza të përparimit shpirtëror të besimtarit	3:18
dashuria e Allahut	3:33
filozofia e haxhit	3:98
gjendjet shpirtërore nuk do të mbeten të fshehta, por do të shfaqen fizikisht	3:107
rezultatet e shpenzimeve të hipokritit	3:118
“ata që gëlltitin zemërimin”; një ngjarje mbresëlënëse	3:135

» <b>Spiritualizmi:</b> djalli i frikëson shokët e vet	3:176
kur e studion universin, nuk duhet të jesh adhures i materies, por ta kërkoshe edhe dorën e Krijuesit	3:192
ata që duan të lëvdohen për diçka që nuk e kanë bërë	3:189
përveç besimtarit të fortë, çdo shpirt është peng i asaj që ka punuar	74:39
duhet ta trajnosh veten me metoda praktike, me durim e përkushtim	3:201; 59:22
njeriu është i dobët dhe duhet t'i kërkojë fuqi Zotit	4:29
ushqimi ndikon në shpirt; edhe lëvizjet fizike ndikojnë në spiritualizmin e njeriut; gjendjet instinktive ndikojnë në gjendjet morale	7:32; 23:52; 5:4; 2:169; 6:119
tri fazat e përparimit shpirtëror	5:94
nuk duhet të ndjekësh verbërisht shumicën; verbëria shpirtërore	5:101; 36:9-10
përmirëso veten para se të përmirësosh tjetrin	5:106
porsi fara që kthehet në një pemë madhështore, edhe njeriu mund të përparojë shpirtërisht	6:96
një ligj në të cilin qëndron sekreti i përparimit ose i rrënimit të njeriut	6:109
druajtja si ushqim gjatë rrugëtimit shpirtëror	2:198
jeta shtazarake e njeriut është vdekje shpirtërore dhe është xhehenemi; jeta e vërtetë dhe vdekja e vërtetë	7:180; 58:23
Islami thekson përmbajtjen më shumë sesa formën	9:19-22
burimi i lumturisë së vërtetë	9:72; 104:8
të gjitha instinktet janë të dobishme; keqpërdorimi i tyre është i dëmshëm	9:100
duhet të shoqërohesh me të vërtetin ( <i>sadik</i> ) për përsosjen e urtësisë	9:119
mirësinë mos e bëj për shpërblim	9:120
organizimi për të larguar dobësitë në besim e në vepra	9:122
si shkatërrohen kombet?	10:28

» <b>Spiritualizmi:</b> Miqtë e Zotit	10:63-65
Ai që ka druajtje ndaj Zotit në kohë paqeje, shpëton në kohë frike	10:91
Zoti i jep dritë atij që ka dritë të brendshme; spiritualizmi i vërtetë	24:36; 11:4;
njeriu që kënaqet vetëm kur ka të mirat	11:10-12; 17:84
ata që punojnë vetëm për jetën e kësaj bote, vetëm për atë shpërblehen	11:16; 53:40
duhen edhe veprat, dhe jo thjesht besimi	11:24
fatzinjtë dhe fatbardhët	11:106
tri gjendjet shpirtërore ( <i>emmareh, levvameh dhe mutmeinneh</i> )	12:54; 75:3; 89:28-31
e vërteta dhe gënjeshtria; dy ilustrime	13:18
qetësia shpirtërore, si arrihet?	13:29
çlirimi nga ligësitë është edhe çlirimi nga xhehenemi; kuptimi i shtatë portave të xhehenemit	15:45-47
njerëzit e xhenetit nuk kanë urrejtje për të tjerët	15:47-48
dy kategori të mohuesve	16:76-77
njerëzit më të këqij	8:23; 8:56; 5:61; 4:146; 25:35; 95:6; 98:7
progresi shpirtëror	16:91; 11:4, 24; 23:2-12; 24:45, 48-51; 35:33; 39:22; 51:17-20, 57; 76:6-7, 18-19; 98:9
dashuria e njeriut ndaj pasurisë, fëmijëve, bashkëshortes, ose edhe tërheqja e tij ndaj tingujve të një zëri të bukur janë pikërisht kërkimi i tij për të Dashurin e humbur; një shembull i bukur	27:45
gjashtë nivelet fizike e shpirtërore të zhvillimit të njeriut	23:1-15
hixhreti (mërgimi) drejt Zotit	29:27
hapi i parë për të arritur urtësinë	31:13
bota shpirtërore dhe bota lëndore janë të ngjashme	30:54; 35:2; 41:40; 51:2-5; 56:76-80; 69:31-33; 76:5
logjika dhe përpjekja janë parakushte për besimin	53:40; 67:11; 38:46; 42:18
ata që kur përballen me pasoja të këqija, ua kalojnë fajin të tjerëve	36:61
si të rrih larg stresit?	10:63-64; 13:29; 9:72; 39:24; 39:54; 42:31
ai që nuk beson në Zot, i duhet të besojë në shumë zota	39:7
punë të mëdha nuk i kryen dot vetëm	40:9

» <b>Spiritualizmi:</b> për ata që “mbeten duke u mburrur me atë dije që kanë”	40:84
njeriu që këshillohet, nuk mbetet pishman	42:39
kur edhe vdekja nuk të sjell humbje	44:57
mosha dyzet vjet mund të jetë e bekuar	46:16
si të largosh mendimet e këqija	50:17; 113:1-6; 114:1-7
spiritualizmi më i lartë i mundshëm	53:1-19; 24:36
<b>Sprova:</b>	2:156-158; 29:4; 2:50, 125, 178, 215, 250; 3:143, 155; 4:63; 6:18; 7:142, 164, 169; 8:26; 16:28; 16:54-55; 17:57, 74; 21:84, 88; 22:36; 23:31; 28:48; 29:11; 30:34, 37; 38:42; 39:9; 41:51; 47:32; 64:12; 68:7
<b>Stresi:</b> si të parandalosh stresin?	10:63-64; 13:29; 9:72; 39:24; 39:54; 42:31
<b>Suksesi:</b> ( <i>feuz e galebe</i> )	23:2; 3:186; 4:14, 74; 5:57; 9:1, 20, 72, 89, 100, 111; 10:10; 24:53; 33:72; 37:61; 39:62; 40:10; 47:6; 58:23; 59:10; 61:13; 78:32
suksesin ( <i>felah</i> ); do ta arrijnë besimtarët, të nënshtruarit	3:201; 2:6, 190; 3:105, 131; 5:36, 91, 101; 7:9, 70, 158; 8:46; 9:88; 20:65; 22:78; 23:2, 103; 24:32, 52; 28:68; 30:39; 31:6; 59:10; 62:11; 64:17; 87:15; 91:10
nuk do ta arrijnë mohuesit, keqberësit	6:22; 6:136; 10:18, 70, 78, 82; 12:24; 16:117; 18:21; 23:118; 28:38, 83
<b>Sulejmani</b> <sup>as</sup> : historia e tij	34:13-16; 38:31-41; 27: 16-45
<i>bismil-lah</i> në letrën e tij	27:31
Zoti i dhuroi urtësinë	21:79-83; 6:87; 27:16
historia e tij	27:16-45; 2:103; 4:164; 6:85; 27:77; 34:13-15; 38:31-41
Kurani e liroi nga akuzat	2:103
nënshtrimi i erërave për të; djajtë punonin për të; kuptimi	21:82-83
<i>nemli</i> , lugina e milingonave apo... ?	27:19
<i>hud-hudi</i> , pupëz apo ... ?	27:21
<i>ifriti</i> , xhind apo ... ?	27:40
një ndjekës i tij që kishte dijen e librit	27:41
ndërtimi i pallatit për mbretëreshën	27:45
<b>Sytë:</b>	20:40-41; 5:46; 16:78; 17:37; 19:27; 28:10, 14; 53:18; 54:51; 75:8; 102:8
sytë e bukur	37:49; 44:55; 52:21; 56:23-24
<b>Sheba:</b> mbretëresha e Shebës	27:23-45; 1:2
populli i Shebës	34:16-20; 27:23-25
<b>Shejtani:</b> djalli	2:37; 7:23 Shih edhe: <b>Iblisi</b>

» <b>Shejtani:</b> kuptimet leksikore	2:15; 2:37
mendjemadhësia e tij	17:62-66; 7:13-17; 38:3
përhap urrejtje	17:54; 5:92; 12:101
frikëson shokët e tij	3:176
i mallkuari	38:78-79; 4:119; 15:18, 36; 81:26; 3:37
i destinuar për në xhehenem	19:69; 15:44; 38:86; 67:6
armiku i njeriut	2:169-170; 2:15, 209, 276; 4:39, 77; 5:92; 6:113, 143; 7:23; 12:6, 101; 17:54; 20:118; 25:30; 35:7; 36:61; 43:63
si ta mundësh atë?	3:201; 7:202
i keq dhe rebel	37:8; 4:61, 77, 118; 19:45; 22:4; 24:22; 26:222-223
liderët e keqberësve gjithashtu janë <i>shejtanë</i>	2:15; 2:103; 38:38
të fuqishmit	21:83; 38:38
të tundon dhe të largon nga rruga e drejtë	2:269; 2:169-170; 4:119-121; 5:92; 6:44; 8:49; 14:23; 15:40; 16:64; 17:65, 78; 19:84; 20:121; 25:30; 27:25; 29:39; 31:22; 58:20
distancimi i tij nga mëkatarët	8:49
nuk ka pushtet mbi robërit e Allahut	34:22; 15:18, 41, 43; 16:100-101; 17:66; 37:8; 58:11
kërko mbrojtjen e Allahut nga ai	7:201-202; 2:169, 209; 6:143; 16:99; 23:98- 99; 41:37; 3:37
tundon duke shfrytëzuar dobësinë e njeriut	24:22; 2:269; 3:176; 4:119-121; 7:21; 14:23
Kurani është i mbrojtur nga prekja e tij	15:18
Profetët nuk mashtrohen prej tij	22:53-54; 3:162; 12:25, 54; 6:113; 38:42; 53:21
u zbret gënjeshtarëve	26:222-225
nuk mund të ndërhyjë në shpalljen e Allahut	26:211-213
<i>taguti</i>	2:257-258; 4:52, 61, 77; 5:61; 16:37; 39:18
<b>Shembulli:</b> i mohuesve	16:76; 66:11
i memecit dhe i njeriut të drejtë	16:77
i një vorbulle të zjarrtë	2:267
i mushkonjës	2:27
i farës së misrit	2:262
i idhujtarit	39:30; 22:32
i qenit të etur (i Bal'em Ba'urit)	7:177
i litarit të Allahut	3:104

» <b>Shembulli:</b> i një kopshti në rrafshnaltë	2:266
i një fshati mosmirënjohës	16:113
i gomarit që mbart libra	62:6
i dy grave për mohuesit	66:11
i dy grave për besimtarët	66:12-13
i zogjve që i përgjigjen thirrjes	2:261
i të verbrit dhe i të shurdhit	11:25
i veprave të mohuesve	14:19
i ligjit Hyjnor	24:44
i dritës së Allahut	24:36
i kotësisë së idhujtarisë	29:42
i kopshtit për besimtarët	13:36
i kopshtit për të drejtët	47:16
i pemës së mirë dhe të keqe	14:25-27
i palosjes së qiellit	21:105
i erës që ka acar	3:118
i shiut jetëdhënës	35:28
i zotërisë dhe i skllavit të tij	30:29
i mirazhit në shkretëtirë	24:40
i përljes së malit	59:22
i atij të cilin e ka çoroditur djalli	6:72; 2:276
i asaj gruaje që prish tjerren e vet	16:93
i njerëzve të kopshtit	68:18-34
i banorëve të fshatit	36:14
i atyre që ndezën zjarr	2:18
i zotave të pafuqishëm	22:74
i Mesihut të Premtuar <sup>as</sup>	f. 752
i shiut dhe i vetëtimës	2:20-21
i rindërtimit të qytezës	2:260
i njeriut të pasur dhe i të varfrit	18:33-45
i pasurisë së kësaj bote	57:21
i farave të mbjella në shkëmb	2:265
i farës që mbin	48:30
i ngrehinës mbi bregun që rrëshqet	9:109-110
i errësirës së dendur	24:41
i jetës së kësaj bote	57:21; 18:46; 10:25

» <b>Shembulli:</b> i së vërtetës dhe i së rremës	13:18
i zhdukjes së ujit	67:31
shërim	10:58; 3:50; 16:70; 17:83; 41:45
i Shpalljeve të mëparshme	2:107; 2:181; 16:102; 18:28; 87:7-8
asnjë ajet i Kuranit nuk shfuqizohet	2:107; 16:102
Shpalljet vijnë vetëm me urdhrin e Allahut	13:39; 57:5
shigjetat e fatit	5:91; 3:45; 5:4
<i>shirku</i> , të barazosh dikë a diçka me Zotin, të shoqërosh dikë a diçka në adhurimin ndaj Tij; t'i sajosh ortak Atij	22:27; 6:15; 10:106; 22:32; 28:88; 30:32
llojet e shirkut	31:14; 112:1-5
Kurani e refuzon dhe nuk e mbështet	112:2-5; 6:101; 10:67, 69; 12:41; 13:17, 34; 16:53; 17:43; 23:92; 112:4-5
është mëkat shumë i madh	31:14; 4:49, 117
nuk falet	4:49, 4:117; 5:73-74; 6:89; 9:113; 22:32; 39:66
njerëzit kur janë në vështirësi, e lusin Allahun, duke i lënë zotat e rremë	16:54
mos kërko falje për idhujtarët e përbetuar	9:113
nuk përparojnë idhujtarët	23:118
mallkimi për idhujtarët	41:7; 6:107; 9:17, 29, 113; 15:95; 33:74; 48:7
Allahu nuk pyetet, por zotat e rremë po	21:24
edhe prindërve bëju mirësi, por mos iu bind nëse të urdhërojnë të bësh <i>shirk</i>	29:9
po të kishte më shumë se një Zot, do të shkatërrohej universi	21:23; 23:92
të adhuruarit përveç Zotit nuk krijojnë dhe janë të vdekur	16:21-22; 7:192; 25:4; 35:14, 41; 46:5
zotat e rremë nuk të sjellin dot as dobi e as dëm	5:77; 6:72; 10:107; 13:15, 17; 21:67; 22:13; 25:56; 29:18
idhujtarët justifikojnë	39:4; 7:174
u shkatërroftë, u shkatërrofshin	3:120; 4:89, 144; 7:100, 156, 171; 8:43; 9:120; 11:61, 96, 116; 12:86; 17:103; 18:36; 20:17, 62, 82; 21:19; 28:89; 40:79, 86; 92:12; 111:2
<b>Shkenca:</b> klima, era, shiu	2:165; 7:58; 15:23; 23:19-20; 25:49-50; 30:49; 35:10; 45:6; 50:10-12 Shih edhe: <b>Universi, Njeriu, Toka, Jeta</b>
krijimi prej uji	24:46
fazat e para të jetës në Tokë	15:29
krijimi në çifte	36:37; 20:54
nata e dita	3:191-192; 2:165; 7:55; 31:30; 36:38; 39:6;

» <b>Shkenca:</b> diversiteti në natyrë	16:14-16; 71:15
embriologjia	22:6; 23:14-15; 39:7; 32:9-10; 35:12; 36:37; 40:68; 65:5; 71:15; 75:38-40; 76:3; 77:21-22; 82:7-9; 86:7-8; 96:2-3
drita arrin te sytë dhe jo sytë te drita	6:104
Kurani nxit studimin e natyrës	67:2-5; 10:102; 3:190-192; 30:31
universi po zgjerohet	51:48; Shih edhe: <b>Universi</b>
shkak-pasojë ndërplanetare	36:39-41
malet	21:32; 15:20; 27:62; 31:11; 78:7-8; 79:33; 88:20-21
krijimi i universit	Shih: <b>Universi</b>
në krijim, gjithçka e llogaritur	25:3; 15:20; 55:8
atmosfera e Tokës	41:10-13; 21:33
bota e kafshëve	6:39; 16:6-9; 16:67-70; 29:42 Shih edhe: <b>Kafshët</b>
përpyekja e njeriut për të zbuluar sekretet e universit përmes shpikjeve të reja	f. 764
rrezet radioaktive që shkatërrojnë çdo gjë	f. 885
rrjeta e merimangës dhe fuqia e saj	f. 667
zjarri i mbyllur në atom	f. 1172
zjarri që së pari sulmon zemrën, pastaj djeg trupin	f. 1172
energji e pashtershme	f. 410
me Dukhanin nënkuptohet edhe tymi që shkaktohet nga luftërat atomike	f. 871
epoka e re e shkencës do të fillonte me zbulimin e Amerikës	f. 1116
zhvillimet në fushën e shkencës të epokës së të mëvonshme, do të ishin dëshmi për vërtetësinë e Kuranit	f. 1084
koncepti i shumë dimensioneve; relativiteti	f. 975
krijesat e para, archaeobacteria, u krijuan prej zjarri	15:27-29 Shih edhe: <b>Njeriu</b>
inxhinieria gjenetike	41:23-23; 4:120
drita mbërrin te syri, duke ia mundësuar shikimin	6:104
çdo gjë e njeriut është ruajtur në qelizat e trupit të tij	41:21-23
<b>Shkurtesat:</b> Suret që fillojnë me shkurtesat ( <i>el-mukatta'at</i> )	Suret nr. 2-3, 7, 10-15, 19-20, 26-32, 36, 38, 40-46, 50 dhe 68.



» <b>Shkurtesat:</b> Shpjegim i shkurtesave	2:2; 7:2; 11:2.
<i>Elif.Lam.Mim.</i>	2:2; 3:2; 29:2; 30:2; 31:2; 32:2
<i>Elif.Lam.Mim.Ra.</i>	13:2
<i>Elif.Lam.Sad.</i>	7:2
<i>Elif.Lam.Ra.</i>	10:2; 11:2; 12:2; 14:2; 15:2
<i>Ha.Mim.</i>	40:2; 41:2; 42:2; 43:2; 44:2; 45:2; 46:2
<i>Ha.Mim.Ajn.Sin.Kaf.</i>	40:2-3
<i>Kaf.Ha.Ja.Ajn.Sad.</i>	19:2
<i>Nun.</i>	68:2
<i>Kaf.</i>	50:2
<i>Sad.</i>	38:2
<i>Ta.Ha.</i>	20:2
<i>Ta.Sin.</i>	27:2
<i>Ta.Sin.Mim.</i>	26:2; 28:2
<i>Ja.Sin.</i>	36:2
<b>Shpenzimi në rrugë të Allahut:</b> të shpenzosh haptas e fshehtas në rrugë të Allahut	13:23 Shih edhe: <b>Bamirësia</b>
edhe në kamje, edhe në skamje	3:135
nga paratë që janë fituar në mënyrë të drejtë	2:268
ta japësh atë që ke përzemër	3:93
të jetë vetëm për hir të Allahut	76:9-10
epoka e Imam Mehdiut do të jetë epoka për të bërë sakrificat të mëdha financiare në rrugë të Allahut	f. 1014
mohuesit shpenzojnë për të penguar të tjerët nga rruga e Allahut	8:37
<b>Shpërdorimi:</b> ekstravaganca ( <i>israf</i> )	17:28; 4:7; 7:32; 17:30; 25:68 Shih edhe: <b>Morali</b>
<b>Shpëtimi:</b> hebrejtë dhe të krishterët	3:25; 2:112, 141
nuk blihet	2:255
për ata që kanë druajtje ndaj Zotit	23:2; 2:6; 19:73; 39:54-56; 91:10
e kushtëzuar me Profetin <sup>savs</sup>	3:32-33; 89:28-31
për jomuslimanët	22:18; 2:63; 20:52-53
parakushtet e tij	2:5-6; 2:63; 44:58
<b>Shpifja:</b>	33:58-59; 4:21, 113, 157; 24:17; 60:13; 68:12 Shih edhe: <b>Përgojimi, Morali</b>

<b>Shpirti:</b> është prej urdhrit të Zotit, dhe njeriu nuk ka shumë dije për të	17:86
“fryj në të prej Shpirtit Tim”, çfarë do të thotë?	15:30; 38:72-74; 66:13; 4:172; 21:92; 32:10;
fjala e Allahut	42:53; 16:3; 40:16
Shpirti i Shenjtë zbret në Natën e Kadrit	97:5
shpirti ( <i>ruh</i> )	4:172; 2:49; 3:26, 146, 186; 6:152; 12:54; 16:3; 17:86; 19:18; 31:29; 50:22; 58:23; 70:5; 75:3; 78:39; 86:5; 89:28-29; 97:5
zhvillimi i tij	32:10; 12:54; 23:15; 56:61-2; 70:5; 75:3
nefsi (vetvetja e njeriut)	12:54; 2:73, 113; 3:29; 4:85; 15:37; 75:3
nefsi <i>emmareh</i> , që nxit për të keqen	12:54
nefsi <i>levvameh</i> , që qorton për të keqen	75:3
nefsi <i>mutmeinneh</i> , i qetësuar	89:28-31
shpirti nuk vdes me vdekjen e trupit	39:43; 50:5
<b>Shpirti i Shenjtë:</b> <i>Ruhul-Kudus</i>	2:88; 2:254; 5:111; 16:103
<i>Ruhul-Emin</i>	26:194 Shih edhe: <b>Xhibraili</b>
<b>Shtatë/shtatëdhjetë:</b> numrat shtatë dhe shtatëdhjetë	31:28; 2:30, 197, 262; 7:156; 9:80; 12:44, 47-49; 15:45, 88; 18:23; 23:18; 69:8, 33; 78:13
<b>Shteti:</b>	2:248
me këshillim	3:160; 42:39
duhet të sigurojë drejtësinë	4:59, 106, 136; 5:9, 34; 20:119-120; 38:23, 27; 42:16; 16:91
vota është amanet, që duhet t'ia japësh atij që i takon	4:59
marrëdhëniet shtetërore	16:93; 3:29; 5:3; 8:73; 16:95; 60:9-10
ata që janë autoritete	4:59-60
rregullat në luftë	2:191-4; 4:76; 8:40, 56-64; 9:1-16; 22:40-42
<b>Shtypurit (të):</b> të dobëtit	14:22; 2:267, 283; 4:10, 76, 98-99; 7:76; 8:27; 9:91; 11:92; 28:5-6; 34:32-33; 40:48
<b>Shuajbi</b> <sup>as</sup> : (Jethro) historia e tij	11:85-96; 7:86; 26:177-190; 28:28
denoncoi pandershmërinë	26:182-184; 7:86; 11:85-86
populli i tij	15:79-80; 7:86; 11:85; 26:177-178
populli i tij u ndëshkua	7:92; 26:190; 29:38
e quajtën gënjeshtar	26:186-188; 7:93
<b>Taluti:</b> historia e tij; Taluti është Davudi <sup>as</sup>	2:250-252
<b>Tavafi:</b>	2:126, 159; 22:30; 22:27
<b>Tehexhudi:</b> namazi i natës	17:80; 2:159; 32:17; 73:3-7, 21

» <b>Tehexhudi:</b> metodë e shkëlqyer për të ndalur dëshirat e ulëta	f. 1063
<b>Tejemumi:</b>	5:7; Shih edhe: <b>Abdesi</b>
<b>Tesnim:</b> pije me <i>tesnim</i>	83:26-29
<b>Testamenti:</b>	2:181-183; 5:107-109 Shih edhe: <b>Trashëgimia</b>
<b>Teurati:</b>	Shih: <b>Bibla</b>
<b>Toka:</b> toka vendqëndrim për njeriun	Shih edhe: <b>Universi</b> 2:30-31; 2:23, 37; 4:98, 101; 7:25; 11:62; 13:4; 15:20; 27:62; 40:65; 43:11; 50:8; 51:49; 55:11; 67:16; 71:20; 78:7; 79:31
Allahu ringjall tokën e vdekur	22:6; 2:165; 16:66; 29:64; 30:20, 25, 51; 35:10; 36:34; 39:22; 41:40; 45:6; 46:34; 57:18
sundimi i Allahut shtrihet në të	2:256; 2:108, 117, 285; 3:110, 130, 181, 190; 4:132, 170; 5:18, 121; 6:13, 80; 7:129, 159; 16:50, 53; 23:85; 24:42, 65; 25:3; 30:27; 31:27; 34:2; 39:45; 42:5; 45:28; 48:15
Allahu i di sekretet e saj	10:62; 2:34; 3:6, 30; 5:98; 6:60; 17:56; 18:27; 22:71; 25:7; 27:66; 34:3-4; 39:47; 49:17; 57:5; 58:8; 64:5
do të shkatërrohet dhe do të thërrmohet tërësisht	89:22; 56:5; 14:49; 39:69-70; 50:45; 69:15; 73:15; 84:4-5; 89:22; 9:2-4; 101:5
krijimi i saj	67:16; 3:191; 6:74; 7:55; 10:4; 11:8; 14:20, 33; 20:5; 21:31; 22:19; 25:60; 29:45, 62; 30:23; 32:5; 35:2; 36:82; 38:28; 39:6; 40:58; 41:10-12; 62:2; 64:4; 65:13; 79:31-34; 84:4
krijimi në të	15:20; 2:165, 169; 3:84, 191; 6:39; 10:24, 67; 13:16; 16:16, 50; 21:20, 32; 22:66; 23:80; 26:8; 27:83; 30:23; 31:11, 21; 45:14; 50:8; 64:4; 71:18
mos bëni çrregullime në të	2:252; 2:12, 28, 61, 206; 5:65; 7:57; 8:73; 16:46; 17:5; 18:95; 29:37; 38:29
shëtitni në të	3:138; 3:157; 4:102; 6:12; 12:109; 14:39; 22:47; 29:20; 30:10, 43; 35:45; 40:22, 83; 47:11; 67:16
krijimi, kthimi dhe ngritja prej saj	20:56
shtatë kontinente	65:13
<b>Toka e premtuar:</b>	7:138; 5:22, 27; 7:130; 17:105; 21:106
<b>Trashëgimia:</b>	2:181-183; 4:8-14, 177; 8:76; 33:7
ligjet e trashëgimisë janë nga Allahu	4:8
Islami u jep pjesë edhe meshkujve, edhe femrave	4:8
pse për mashkullin sa pjesa e dy femrave?	4:12

» <b>Trashëgimia:</b> nuk u lejohet burrave që t'ua marrin grave trashëgiminë me zor	4:20
përpara vdekjes, ta lësh testamentin për prindërit dhe të afërmit	2:181
nuk duhet ta tjetërsosh testamentin e dikuajt	2:182
nuk është gjynah të këshillosh testamentuesin për përmirësim, nëse gabon	2:123
trashëgimia ndahet pasi të zbatohet testamenti dhe të shlyhet borxhi	4:12-13
gjatë ndarjes së trashëgimisë, jepuni diçka edhe nevojtarëve	4:9
<b>Trinia:</b>	4:172; 5:74; 19:2; 19:91-93; 43:82; 112:2-5
<b>Themudët:</b>	15:81; Shih edhe: <b>Salih</b> <sup>as</sup>
ndërtonin shtëpi prej guri	7:75; 26:150
mohuan Allahun dhe të Dërguarit	11:69; 7:77; 22:43; 26:142; 54:24; 91:12
deveja si shenjë prej Zotit	7:74; 7:78; 11:65-66; 17:60; 26:156-158; 54:28-29; 91:14-15
u ndëshkuan	11:68; 7:79; 11:66, 96; 41:14; 54:32; 69:6
<b>Udhëzimi:</b> Allahu nuk i udhëzon këta	2:259; 2:265; 3:87; 5:52, 68, 109; 6:145; 9:19, 24, 37, 80, 109; 16:38, 108; 28:51; 39:4; 40:29; 46:11; 61:6, 8; 62:6; 63:7
Allahu i udhëzon këta	20:51; 2:121, 186, 214; 3:74, 102; 4:69; 5:17; 6:36, 72, 89, 150; 7:44, 179; 10:10, 26, 36; 13:28, 32; 14:5, 13; 16:10, 94, 122; 19:77; 22:17, 38; 24:36, 47; 26:63, 79; 28:57; 29:70; 31:5-6; 33:5; 35:9; 37:119; 39:19, 24, 38; 42:14; 47:18; 48:3, 21; 49:18; 64:12; 74:32; 76:4; 93:8;
udhëzimi nga Profeti	27:81-82; 3:21
lutje për udhëzimin	1:6; 3:9
<b>Uji:</b> Arshi i Allahut mbi ujë, ç' domethënë?	11:8
sistemi i ujit në Tokë	f. 386
Allahu nëse do, mund ta bëjë ujin të shterojë	23:19; 67:31
përmes ujit u krijua çdo gjallesë	21:31; 24:46
krijimi i njeriut prej uji	25:55
bimësia prej ujit	6:100
ushqimi nëpërmjet ujit	2:23; 16:15
<b>Ulliri:</b>	24:36; 95:2; 23:21; 6:100, 142; 16:12; 80:30
<b>Umreja:</b>	2:197; 2:159; 48:2, 28

<b>Ungjilli:</b> <i>Inxhili</i>	Shih: <b>Bibla</b>
<b>Universi:</b> krijimi i tij	7:55; 2:23, 118; 21:31, 34; 30:23, 26; 32:5; 36:39-41; 41:12-13; 51:48; 55:6, 8; 67:4-6
universi po zgjerohet pa pushim	51:48
universi ishte i mbyllur, dhe u hap në formë Big Bang-u; vrima e zezë e vrima e bardhë	21:31; 21:105; 39:68
gjashtë etapa të universit; gjashtë etapa janë proces i zhvillimit deri në përsosmëri	10:4; 7:55; 11:8; 25:60; 50:39; 57:5; 32:5
krijimi i universit, krijimi i errësirave dhe krijimi i dritës	6:2
universi qëndron në këmbë në shtylla të padukshme	31:11
orbita e trupave qiellorë; secili po lundron në orbitën e vet	36:39-41; 2:30; 10:6; 21:31, 34; 23:18; 51:8; 77:26-27
shkak-pasojë ndërplanetare	20:7; 50:39; 25:60; 32:5
i gjithë universi në lëvizje	36:39-41
Zoti a iu deshën gjashtë ditë që ta krijonte universin?	25:60
krijimi i universit në gjashtë ditë; gjashtë etapa	10:4; 7:55; 11:8; 25:60; 32:5; 50:39; 57:5
krijimi i shtatë qiejve	65:13; 67:4; 71:16; 23:87; 78:13; 2:30; 17:45
krijimi i shtatë qiejve në shtresa	67:4; 71:16
krijimi në shtatë etapa	7:55; 10:4; 11:8; 25:60; 32:5; 57:5
shtatë rrugë në qiej	23:18
shtatë qiej e shtatë Toka	65:13
krijimi i errësirave dhe i dritës	6:2
Zoti e krijoi për një afat të caktuar	30:9; 46:4
zinxhiri shkak-pasojë	53:43
mbrojtja e universit lëndor dhe shpirtëror	37:7-11
universi shkatërrohet; Zoti nuk asgjësohet	55:27-28; 21:105; 39:68; 46:4
vendshfaqjet e yjeve dhe Kurani	56:76-80
është krijuar në shërbim të njeriut	2:165; 25:60-63; 45:14; 79:28-34
nuk ka të metë në krijimin e tij	67:4-5
qiejt, Tokën dhe gjithçka që është mes tyre, Allahu nuk i krijoi pa qëllim	15:86; 3:191-192; 16:4; 38:28; 44:39-40; 46:4
... nuk i krijoi duke bërë lojë	21:17
dallimi mes krijimit të Allahut dhe të njeriut	56:58-74
Allahu nuk lodhet nga krijimi	46:34; 50:39

» <b>Universi:</b> Allahu është i Plotfuqishëm të krijojë univere të tjera si ky	17:100; 36:82
gjendja fillestare	21:31; 41:12
krijimi nga asgjëja	f. 386
krijimi i atmosferës së Tokës në shtatë shtresa në periudha të ndryshme	41:10-13
qielli i Tokës i zbukuruar dhe mbrojtës	41:13
qielli i Tokës i zbukuruar me yje	37:7; 67:6
rrotullimi i trupave qiellorë	36:41
Toka po rrotullohet; lëvizja e Tokës	27:89; 70:41
lëvizja e diellit dhe e gjitha galaktikave; i gjithë universi është në lëvizje	36:41
profecia që qielli do të kishte rrugë	51:8
krijimi i diellit, i hënës, i ditës dhe i natës	21:34
dielli ka dritën e vet, kurse hëna e ka të huazuar	10:6
në ndërrimin e ditës dhe të natës ka shenja për të mençurit	3:191; 2:165; 10:7
hapja e qiejve	78:20
dalje nga kufijtë e qiejve dhe të tokës	55:34; 15:15-16
kur qielli të shpohet	77:10
kur qielli të çahet	82:2
kur qielli të zhvishet	81:12
qiellin do ta mbulojë tymi	44:11-12
qielli do të tronditet fort	52:10
qielli me yjësi	85:2
për çdo gjë, në momentin e krijimit të saj, u përcaktuan edhe cilësitë	25:3
edhe jeta shpirtërore u bazua në “ujë”	11:8
në sy të Zotit muajt janë 12	9:36
nuk sheh dot asnjë të metë në gjithë këtë univers	67:4-5
shkencëtarët i zbulojnë sekretet e universit nga kërkimet e tyre, kurse Profetët i mësojnë prej Zotit	6:76
graviteti	f. 386
një përlllogaritje për moshën e universit në dritën e ajeteve të Kuranit	f. 1047
gjihtëçka në univers është e vdekshme	55:27

» <b>Universi:</b> Allahu do ta palosë universin në “Dorën” e Tij të djathtë	39:68
pasi ta asgjësojë universin, Zoti do ta krijojë atë sërish	21:105; f. 526
trupat qiellorë vetë nuk qëndrojnë në këmbë	f. 742
krahët e engjëjve nënkuptojnë edhe 4 valencat e atomit	f. 741
çdo gjë e universit është në çift	36:37; 2:26
jeta me bazë karboni	f. 741
bakteret e para prej zjarri	15:28
ka gjallesa edhe jashtë Toke, që dikur do të kenë kontakt me ne (jeta jashtëtokësore)	65:13; 42:30; 59:25
jeta jashtëtokësore	f. 844
sistemi i ciklimit të ujit	f. 386
dy shkaqe që mund ta zhdukin ujin nga Toka	f. 561
çdo formë e jetës përfiton nga uji	f. 741
dhuratë e madhe	2:270;
<b>Urtësia:</b> urtësia e Lukmanit	31:13
të jesh mirënjohës është baza e urtësisë	31:13
urtësia ( <i>hikmet</i> )	2:130; 2:252, 270; 3:49, 59, 80, 82, 165; 4:55, 114; 5:111; 6:74; 10:2; 14:20; 16:126;17:40; 19:13; 21:75, 80; 26:84; 28:15; 31:3, 13; 33:35; 36:3; 38:21; 40:68; 43:5, 64; 44:5; 54:6; 62:3; 71:14
<b>Uzejri<sup>as</sup>:</b> Ezra	9:30
<b>Vaji:</b>	24:36; 3:46; 23:21
<b>Varfër (i):</b> i varfër	90:12-17; 2:272; 3:182; 4:7, 136; 9:60; 22:29; 24:33; 28:25; 35:16; 47:39; 69:35;107:4
<b>Varrimi:</b>	80:22; 5:32; 36:52-53; 100:10
<b>Vdekja:</b> çdo njeri do të vdesë	4:79; 21:35
pas vdekjes, nuk ka kthim në këtë botë	23:101
dy vdekje e dy jetë	40:12
edhe gjumi është një lloj vdekjeje	39:43
<i>exheli</i> dhe vdekja aksidentale	6:3
<i>berzahu</i> pas vdekjes	23:101
kohëzgjatja mes vdekjes dhe ringjalljes	f. 561-562
“Mos vdisni kurrsesi, përveçse kur të jeni të nënshtruar!”	2:133; 3:103

» <b>Vdekja:</b> ““vdisni” para se t’ju vijë vdekja!”	2:244
vdekja për mohuesit	9:55; 50:20; 6:94
<b>Veprat:</b> Allahu jua di veprat	10:62; 4:128; 6:133; 11:112; 14:43; 29:9; 53:33;
duken joshëse	27:5; 6:44; 8:49;16:64; 27:25; 29:39; 35:9; 40:38; 47:15
si sprovë	7:156; 5:49; 6:166; 11:8; 18:8; 67:3
çdokush është përgjegjës për veprat e veta	45:16; 2:140, 282; 3:26; 4:85; 6:165;10:42; 17:16; 28:56; 32:19; 35:19; 38:29; 39:8, 71; 42:16; 45:22; 53:39; 68:36; 109:7
vepra e keqe dënohet aq sa është ajo	6:161; 24:40; 28:85; 53:32
veprat e ndaluara	6:152; 5:96; 7:34; 16:91; 17:33-34
janë të shënuara plotësisht	45:30; 10:62; 34:4; 54:53-4; 82:11-3; 99:8-9
shembulli i veprës me një fluturak	17:14
vepra e mirë shpërblehet në mënyrë të shumëfishtë	6:161; 2:262; 4:41; 27:90; 28:85
u zhvlerësohen atyre që e refuzojnë besimin	47:9-10; 5:6; 7:148; 11:17; 18:104-107; 25:24; 47:2, 33; 49:3
lutjet dhe namazi të ndalojnë nga veprat e këqija	29:46
ndëshkimi për veprat e këqija	27:91; 10:28; 29:56; 30:42; 32:15; 39:49; 41:28; 58:16; 101:9-10
asgjë nuk do të fitosh përveç asaj për të cilën je përpjekur	53:40
shpërblimi për veprat e mira	28:85; 3:196; 4:41, 58, 174; 5:10; 7:9, 44; 9:121; 11:16, 112; 16:98; 17:10; 18:3, 47, 108-9; 19:77; 20:76-77; 22:15, 57; 24:39; 29:8, 10; 31:9-10; 32:18, 20; 33:30; 34:38; 35:8, 11, 33; 39:36; 41:9; 42:23-24, 27; 43:73-74; 45:31; 46:20; 47:13, 36; 48:30; 52:18-21; 65:12; 84:26;85:12; 95:7; 98:8-9; 99:8; 101:7-8
<b>Vetëvrasja:</b>	5:106; 2:196; 12:88; 15:57; Shih edhe: <b>Stresi</b>
<b>Vërteta (e):</b> e vërteta, <i>hakk</i>	58:22; 2:43, 62, 147-148; 3:72; 5:117;10:77; 12:52; 13:18; 19:35; 21:19, 111; 42:25; 51:20; 70:25; 77:2-7
premtimi i Allahut është i vërtetë	9:111; 4:123; 10:5, 56; 11:46; 16:39; 18:22, 99; 31:10
mos e përzini të vërtetën me të rremen, as mos e fshihni atë	2:43, 2:147, 175; 3:72; 4:172; 5:16, 49; 6:67, 92; 7:170
është me Allahun	6:74; 6:58; 10:31, 33, 36; 13:15; 18:45; 20:115; 22:7; 23:117; 24:26; 25:27; 31:31; 33:5; 39:70, 76; 40:21; 42:25



» <b>Vërteta (e):</b> Islami është e vërteta	9:33; 5:84-85; 10:109; 37:38; 48:29; 61:10
Profetët sollën të vërtetën	3:87; 2:120; 3:61, 63; 4:171; 7:44, 54; 10:109; 17:82; 34:50; 35:25; 37:38; 3:4; 2:92, 177, 214, 253; 4:106; 5:49; 6:115; 11:18, 121; 13:2; 16:103; 35:32; 39:3, 42; 42:18; 45:7
ata që e refuzojnë	56:52; 56:53, 93; 68:9; 69:50; 73:12; 77:16, 20, 25, 29, 35, 38, 46, 48, 50; 83:11
<b>Vërteti (i):</b> i vërteti, <i>sadik</i> , ata që kokë e këmbë janë të vërtetë	2:178; 3:18, 80; 4:70, 88, 123; 5:76, 120; 6:147; 9:119; 12:28, 52; 15:65; 19:42, 57; 27:50; 29:4; 33:9, 25, 36; 57:20
nëse thoni të vërtetën, nëse jeni të vërtetë	2:24; 2:95, 112; 3:94, 169, 184; 6:41, 144; 7:71, 107, 195; 10:39, 49; 11:14, 33; 15:8; 21:39; 26:155, 188; 27:65, 72; 28:50; 32:29; 34:30; 36:49; 40:29; 37:158; 45:26; 46:23; 49:16, 18; 56:88; 62:7; 68:42
<b>Xhamia:</b>	2:115; 72:19; 2:145, 151, 188, 192, 218; 5:3; 7:30, 32; 8:35; 9:17-19, 108; 17:2; 22:26; 48:26, 28
xhamia aksa (xhami e largët)	17:2
xhamia për të lënduar; <i>xhamia e dëmshme</i>	9:107-108
<b>Xhehenemi:</b> ferri, shkak i veprave të njeriut	19:69, 72; 7:148; 10:45, 53; 17:73; 23:52
gjendja në të	17:98; 3:107, 182; 6:71; 8:51; 10:28; 11:107; 14:17, 51; 15:45; 16:30; 18:30, 101; 19:72; 21:40, 101; 22:20-23; 23:105; 25:35; 26:92; 27:91; 32:21; 37:63; 38:58; 39:61, 72-73; 40:72-73; 44:44-47, 49; 47:16; 54:49; 55:45; 56:43-45, 53-55, 94; 67:8, 28; 69:33, 37; 76:5; 78:25-26; 88:6-8; 102:7
për mohuesit, hipokritët dhe idhujtarët	29:55; 2:25, 40, 127, 258; 3:11, 13, 132; 4:141, 146; 5:73; 8:37; 19:87; 25:12; 38:60; 41:20; 44:48; 67:7; 78:22; 79:37; 83:16-18; 88:5; 89:24; 98:7
për të pabindurit	2:207; 3:163; 4:15, 56; 9:63; 10:8-9; 13:19; 14:29-30; 21:30, 99; 40:61, 71-73; 50:27; 72:24
për djallin	38:86; 4:120-122; 7:19; 17:64; 19:69; 26:92-96; 36:64
për ata që i quajnë gënjeshtër ose i fshehin shenjat e Allahut	2:40; 2:175; 4:57; 18:107; 40:71-73; 45:12, 35, 36; 57:20; 64:11; 73:12-14; 90:20-21
për ata që nuk i binden Allahut; për keqbërësit	10:28; 2:82, 276; 3:182; 4:11, 94, 116; 8:38; 11:17, 107; 13:26; 14:16-17; 16:30; 17:19; 19:87; 20:75; 21:99; 23:104-105; 27:91; 38:56-57; 39:61, 73; 40:44, 77; 43:75; 50:25-26; 54:48-49; 55:44; 71:26; 72:16; 82:15; 85:11; 92:15-16; 101:9-10; 104:3

» <b>Xhehenemi:</b> nuk ka shpëtim prej tij	20:75; 2:87; 3:92, 107; 25:15; 32:21; 35:37; 40:50; 87:14
“çdokush nga ju do të bjerë në të”, kuptimi	19:72
Zoti nuk ngarkon askënd përtej kapacitetit të tij;	2:287
shtatë portat e tij, domethënie	15:45
përshkrimi i tij dhe domethënia	76:5; 69:31-33; 17:73; 34:55; 50:23, 31; 36:10; 54:32; 57:16; 67:11; 104:8; f. 965
zjarre të kësaj bote dhe të ahiretit	69:33; 2:202
ndryshe nga xheneti, xhehenemi nuk është i përhershëm	78:24; 11:108-109; 7:157; 40:8
“nëntëmbëdhjetë rojtarë (engjëj) mbi xhehenemin” dhe një kuptim i tij	74:31-32; f. 1067
“çdokush do të bjerë në të” dhe kuptimi i tij	19:72
mirëbërësit nuk do të dëgjojnë as fëshfërimën e tij	21:103
xhehenemliu as do të vdesë, as nuk do të jetojë	87:14
nëse xheneti është kaq i madh, ku do të jetë xhehenemi? përgjigjja e Profetit <sup>savs</sup>	f. 975
<b>Xheneti:</b> besimtarët që bëjnë vepra të mira do të hyjnë në të	2:26; 2:83; 3:199; 4:58, 123, 125; 7:43; 10:10; 11:24; 14:24; 15:46; 16:31-32; 18:108; 19:61, 64; 20:76-77; 22:15, 24, 57; 25:16; 29:59; 30:16; 31:9; 32:20; 38:50-51; 40:41; 42:23; 44:52-53; 47:13; 51:16; 54:55; 64:10; 65:12; 68:35; 85:12; 89:29-31; 98:8-9
si dhe kur e arrijnë besimtarët xhenetin?	2:215; 3:143
përshkrimi dhe domethënia	2:26; 32:18; 47:16; 13:36; 16:32; 14:7; 37:60-66; 50:32-36; 52:25; 56:20-27
pasja e bashkëshortëve të dëlirë në të	2:26; 3:16; 36:57; 37:49-50; 38:53; 44:55; 52:21, 25; 55:57, 59, 71, 73, 75; 56:18; 56:23-24; 56:35-38; 76:20; 78:34
kuptimi i kopshteve dhe lumenjve	2:26
përshkrim i xhenetit	76:12-23; 2:26; 3:134; 7:43-44; 9:72; 13:25, 36; 15:46-49; 16:31-32 18:32, 108-109; 19:62-63; 22:24; 25:17, 25, 76-77; 29:59; 30:16; 34:38; 35:34-36; 36:56-60; 37:41-50; 38:50-53; 39:21, 35; 40:41; 41:32; 42:23-28; 43:71-74; 44:52-56; 47:16; 50:36; 52:23, 24, 28; 55:47-78; 56:13-38; 57:22; 65:12; 69:22-25; 76:6-7; 77:42-43; 78:32-37; 83:25-29; 88:11-17
përshkrimi i tij nuk e ka kuptimin fizik	f. 965

» <b>Xheneti:</b> në tokë	2:36; 2:266-267; 6:100, 142; 13:5; 17:92; 18:33, 34, 36, 40, 41; 25:9; 26:58, 135, 148; 34:16; 50:10; 55:47; 68:18; 71:13; 78:17
përjetësia e tij	11:109; 4:58; 7:43; 9:100; 13:24; 15:49; 18:109; 20:77; 35:36; 44:57
familjet ribashkohen në të	40:9; 13:24; 43:71; 52:22
hyritë në të	37:49-50; 38:53; 55:73-75; 44:55; 52:21; 56:23-27, 56:36-38
<i>Eden</i>	9:72; 13:24; 16:32; 18:32; 19:62; 20:77; 35:34; 38:50-51; 40:9; 61:13; 98:9
<i>aliye</i> (i lartë)	88:10-11; 69:22-23
<i>Firdeus</i>	18:108; 23:12
<i>khuld</i> (i përjetshëm)	25:16
<i>me'va</i> (strehë)	32:20; 53:15-16
<i>naim</i> (me plot bekime)	26:86; 5:66; 10:10; 22:57; 31:9; 37:44; 56:13, 90; 68:35; 70:39
paqja e tij	10:11; 10:26; 13:25; 14:24; 15:47; 19:63; 36:59; 39:74; 50:35; 56:26-27
<i>reudatul-xhennat</i>	42:23
si shpërblim për: burra e gra të ndershme, dëshmorët, muhaxhirët, të duruarit, që i druhen Allahut, të penduarit, etj.	18:32; 2:26; 3:16, 134, 196, 199; 4:14, 58; 5:66, 120; 7:44; 9:72, 100, 111; 10:10, 27; 11:109; 13:23-25, 36; 15:46-49; 16:33; 19:61- 63; 21:102-104; 23:2-12; 25:76-77; 26:91; 32:20; 35:33-34, 36; 36:26-27; 37:42-50; 39:21; 40:41; 41:31-33; 43:69-74; 46:14-15; 47:5-7, 16; 48:18; 50:32-36; 52:18-28; 55:47- 59, 63-79; 56:12-39, 89-90; 57:13, 22; 59:21; 61:12-13; 66:9, 12; 74:40-41; 76:6-7, 12-23; 77:42-5; 78:32-37; 82:14; 83:23, 26- 29; 88:9- 17; 89:28-31
besimtarët do ta shohin Zotin	75:23-4
afrimi i tij	26:91; 50:32; 81:14
xheneti që ka gjerësinë e qiejve e të tokës	3:135; 57:22
<b>Xhenxhefli:</b> <i>zenxhebil</i>	76:18
<b>Xhibraili:</b>	2:98-99; 26:194; 66:5; 81:20 Shih edhe: <b>Engjëjt</b>
<b>Xhihadi:</b> është për Allahun	29:70; 2:219, 252; 3:143; 4:96; 5:36, 55; 8:73, 75- 76; 9:16, 19-20, 24, 41, 44, 73, 81, 86, 88; 16:111; 22:79; 29:7; 49:16; 60:2; 61:12
urdhri i parë	22:39-42; 2:191
xhihadi me armë është i kushtëzuar me rrethana të caktuara	25:53; 2:194; 2:191; 22:42; 25:53

» <b>Xhiahadi:</b> sot kur ka liri fetare, nuk ka xhihad me armë	25:53
arsyet e xhihadit me armë	25:53; 8:31; 9:10-13; 22:41
llojet e xhihadit në Islam	25:53; 9:73
përgjigjja e akuzës se gjoja Islami porositi të luftosh me jomuslimanët derisa ata të bëhen muslimanë	2:194; 47:5
xhiahadi me armë synoi lirinë e fesë	22:41; 2:194; 8:40, 62
ishte për të ndëshkuar disa njerëz që	9:5
u mbrojtën edhe idhujtarët	9:4, 6, 7
katër muaj periudhë armëpushimi	9:2
në luftë nuk lejohet padrejtësi	2:191; 16:127; 5:9
në luftë duhen respektuar traktatet	9:4
nëse armiku anon nga pajtimi, duhet të bëni pajtimin	8:62
pajtimin mos e bëni nga frika	47:36
porosia se si ta ndalni luftën mes dy popujve	49:10; f. 911
nuk lejohet të mbahen të burgosur lufte, pa ndodhur një luftë e përgjakshme	8:68
të burgosurit e luftës lirojini ose duke pranuar shpagimin, ose me mirësi	47:5
të drejtat e të burgosurve të luftës	24:33-34
vendosni kampe ushtarake nëpër kufi	3:201
sipas mundësisë, të jeni të përgatitur për t'iu përgjigjur sulmeve	8:61
kur ka luftë, duhet të tregohesh trim dhe nuk duhet t'ia kthesh shpinën	8:16-17; 8:58
ata që bien në rrugën e Allahut, janë dëshmorë	3:141; 2:155; 3:170
xhiahadi kundër vetvetes dhe bekimet e tij	29:70; Shih edhe: <b>Spiritualizmi</b>
xhiahadi përmes Kuranit është xhiahadi madhor	25:53
xhiahadi përmes pasurisë	8:73
Allahu i do ata që bëjnë xhihad në rrugën e Tij	61:5
vrulli i sahabëve për xhihad, pavarësisht nga pamundësia	9:92
leje për të sëmurin dhe të pamundurin për të munguar në xhihad	48:18

» <b>Xhihadi:</b> lejimi me kusht i luftës gjatë muajve të ndaluar	2:195; 2:218
lejimi me kusht i luftës në Xhaminë e Shenjtë	2:192
<b>Xhindët:</b> krijesë e Allahut	6:101
kuptime leksikore	6:129
qëllimi i krijimit të tyre	51:57
janë njerëz të pushtetshëm që publiku i thjeshtë nuk ka qasje t'i shohë; njerëzit e fuqishëm malësorë	6:129, 131; 72:2-10; 6:113; 34:42; 41:30; 46:30-33; 51:57
nënkuptojnë edhe mikroorganizmat	15:28
ndëshkohen njësoj si njerëzit	32:14; 11:120; 15:43-44; 38:86
vizita e tyre te Profeti <sup>savs</sup>	46:30; 72:2
pas vizitës te Profeti, ata u kthyen dhe e nxitën popullin e tyre të besonin në mesazhin e Profetit	46:32-33
besonin se Allahu nuk do të dërgojë më ndonjë të dërguar	72:8
lutje për mbrojtje kundër tyre	114:7
xhindët e Davudit <sup>as</sup>	27:40
xhindët e Sulejmanit <sup>as</sup>	34:13
me xhindët nënkuptohen edhe malësorët që janë të fuqishëm fizikisht	27:40
xhindët dhe njerëzit dhe marrëdhëniet e tyre	6:129
<b>Xhizja:</b>	9:29
<b>Ylli:</b> <i>nexhm</i> , yjet	53:2-3; 6:77, 98; 7:55; 12:5; 16:13, 17; 22:19; 24:36; 37:7; 41:13; 56:76; 67:6; 77:9; 81:3; 82:3; 86:2-4
<b>Zakonet:</b> e arabëve	5:104; 2:179; 3:162; 6:137-142; 7:74; 9:37; 11:57, 80; 16:60; 33:5; 53:10; 58:2
e egjiptasve	20:89
traditë e bijve të Izraelit	19:17; 3:36
<b>Zbukurimi:</b> ornamente	18:8; 7:149; 10:25; 13:18; 16:7, 15; 18:47; 20:88; 24:32; 33:41; 35:13; 37:7; 43:19
Zoti e zbriti në formë veshjeje	7:27
Zbukurimi ( <i>zineh</i> )	7:32-33
i qiejve	15:17; 22:24; 37:7; 41:13; 50:7; 67:6
i kësaj bote	28:61; 7:33; 11:16; 16:9; 18:8, 29, 47; 20:60, 88; 24:32, 61; 28:80; 33:29, 34; 37:7; 57:21

<b>Zeburi:</b> Psalmet	17:56; 21:106; 4:164
shkrimet Hyjnore ( <i>zibur</i> )	3:185; 5:79;16:45; 26:197; 27:34
<b>Zekati:</b> është obligim	2:44, 84, 111, 178; 98:6
mjet për pastrimin shpirtëror dhe të pasurisë	9:103
të jepet vetëm për hir të Allahut	30:40
besimtarët e veçantë nuk i pengon tregtia ta japin zekatin	24:38
ku përdoren paratë e zekatit?	2:274; 9:60
zekati	9:60; 2:44, 84, 111, 178, 278; 4:163; 5:13, 56; 7:157; 9:11, 18, 71; 19:32, 56; 21:74; 22:42, 79; 23:2-5; 24:38, 57; 27:4; 30:40; 31:5; 33:34; 41:8; 58:14; 73:21; 98:6 Shih edhe: <b>Sadakaja</b>
në kuptimin e pastërtisë	19:14; 18:82
<b>Zekerija<sup>as</sup>:</b>	19:3-12; 3:38-42; 6:86; 21:90-91
<b>Zekkumi:</b>	37:63-67; 14:27; 44:44-5; 56:53-54
<b>Zemërimi:</b> i Allahut	1:7; 43:56; 2:62; 2:91; 3:113; 4:94; 5:61; 8:17; 16:107; 43:56; 48:7; 60:14
zemërimi i njeriut	3:135; 3:120; 7:155; 9:15; 21:88; 33:26; 42:38; 67:9
<b>Zemra:</b>	53:12; 3:30, 120; 7:44; 9:14; 10:58; 15:48; 17:37; 22:47; 25:33; 28:11; 29:50; 40:20; 100:10-11; 104:8; 114:6
Allahu ua hap zemrat	6:126; 7:3; 20:26; 94:2
e dhuroi Allahu	16:79; 2:98; 23:79; 26:195; 32:10; 46:27; 67:24
ua fut frikën në zemra	3:152; 8:13; 33:27; 59:3
të sëmura	2:11; 5:53; 8:50; 9:125; 22:54; 24:51; 33:13, 33, 61; 47:21, 30; 74:32
të frikësuar	8:3; 22:36; 23:61; 33:11; 39:24; 40:19
të ngurta	2:75; 3:160; 5:14; 6:44; 10:89; 39:23; 57:17
të dashuruara	3:104; 8:64; 9:60
që kanë shtrembëri	3:8-9; 9:117; 61:6; 66:5
të vulosura, të ndryshkura, të verbra	18:58; 2:8, 89; 4:156; 6:26, 47, 111; 7:101-102, 180; 9:87, 93, 110; 10:75; 11:13; 14:44; 15:98; 16:109; 17:47; 18:29; 22:47; 23:64; 26:14; 30:60; 40:36; 41:6; 42:25; 45:24; 47:17, 25; 59:15; 63:4; 83:15
çfarë do të thotë vulosje e zemrës nga Zoti?	2:8
të forta, të lidhura	18:15; 8:12; 11:121; 28:11

» <b>Zemra:</b> me paqe	48:19; 2:249, 261; 3:127; 5:114; 8:11; 9:26, 40; 13:29; 16:107; 48:5, 27
<b>Zilia:</b>	113:6; 2:110, 214; 3:20; 4:55; 24:51; 28:83; 42:15; 45:18; 48:16
<b>Zjarri:</b> u bë i ftohtë dhe i sigurt për Ibrahimin <sup>as</sup>	21:70; 29:25
<b>Zoti:</b> Zoti i Madhërishëm	Shih: <b>Allahu</b>





# Bibliografi

Siç u tha në faqet X – XII, të gjitha shpjegimet e ajeteve janë marrë nga literatura e shërbëtorit të vërtetë të Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, Hazret Mirza Ghulam Ahmed i Kadianit, Mesih i Premtuar dhe Imam Mehdi, si dhe nga literatura e Kalifëve të tij të nderuar. Librat e haditheve, fjalorët, *tefsiret* (komentimet) e mëparshme të Kuranit, enciklopeditë, etj., që janë cituar në shpjegimet e ajeteve, janë pasqyruar më poshtë.

- Akrab: Sa'id el-Khuri esh-Shertuni, fjalori “Akrebul-Mevarid fi Fusahil-‘Arabijjeti vesh-Shevarid”, Kum 1403 h./ 1983.
- Askalani, Sherh Buhari: Ibn Haxher el-‘Askalani, komentimi i tij i Buhariut “Fet’hul-Bari fi Sherh Sahihul-Buhari”, botues: “Er-Risaletul-‘alemijje”, Bejrut, 1434 h. / 2013.
- Bejhaki: Ebu Bekr El-Bejhaki, “Ez-Zuhdul-Kebir”, botues: “Darul-xhinan ve muessesetu el-kutub eth-thekafijje”, Bejrut 1987.
- Bibla: Bibla, Dhiata e Vjetër dhe Dhiata e Re.
- Bihar el-Envar: Allama Mexhlisi, “Biharul-envar”, botues: “Muessesetel-Vefa”, Bejrut 1983.
- Buhari: Muhammed ibn Ismail el-Buhari, “Sahih”, botues: “Ibn Kethir”, Damask, 1423 h. / 2002.
- Ebu Davud: Ebu Davud es-Sixhistani, “Sunen”, botues: “Er-Risaletul-‘alemijje”, Bejrut 1430 h. / 2009.
- Ebu Hajjani: Ebu Hajjan el-Endelusi, “Tefsir el-Bahrul-Muhit”, botues: “Kutub el-‘ilmijeh”, Bejrut 1413 h. / 1993.
- El-Kamusul-Muhit: El-Firuzabadi, “El-Kamusul-Muhit”, Bejrut 2005.
- El-Kurtubi: Ebu ‘Abdullah el-Kurtubi, “El-Xhamiu li-Ahkamil-Kuran”, botues “Muessesetur-Risaleh”, Bejrut 1427 h. / 2006.
- Enc. Bib.: “Encyclopedia Biblica”.
- Enc. Brit.: “Encyclopedia Britannica”.
- Endelusi, Bahrul-Muhit: Ebu Hajjan el-Endelusi, “El-Bahrul-Muhit fit-Tefsir”, botues: “Kutub el-‘ilmijeh”, Bejrut 1413 h. / 1993.
- Erbili: Ebul-Hasan ‘Ali bin ‘Isa bin Ebil-Fet’h el-Erbili, “Keshful-gummeh fi ma’rifetil-eimmeh”, vëllimi II, botues: “Darul-kutub el-islamijeh”, Bejrut 1401 h. / 1981.
- Hutchinson’s History of the Nations: Walter Hutchinson, “History of the Nations: A Popular, Concise, Pictorial and Authoritative Account of Each Nation from the Earliest Times to the Present Day”, botues: “Hutchinson & Co”, Londër, pa vit botimi.
- Ian Wilson: “Exodus Enigma”, botues: “Weidenfeld & Nicolson”, Montgomery 1985.
- Ibn Kethir: Hafidh ibn Kethir, “Tefsirul-Kur’anil-‘Adhim”, botues “El-Kutub el-‘ilmijeh”, Bejrut, 1419 h. / 1998.
- Ibni Maxhe: Ebu ‘Abdullah Muhammed Ibn Maxhe, “Sunen”, botues: “Ihja et-turath el-‘arabijje”, Bejrut 2009.

- Imlau ma menne bihir-Rrahman: Ebul-Bika ek-'Ukberi, "Imlau ma menne bihir-Rrahman min vuxhuhil-i'rabi vel-kira'at fi xhemi'il-Kuran", botues: "El-Kutub el-'ilmijje", Bejrut 1389 h. / 1970.
- Jew Enc.: "The Jewish Encyclopedia", 12 vëllime, vëll. I u botua në vitin 1901.
- Kenzul-ummal: Alauddin El-Mutteki El-Hindi, "Kenzul-'Ummal", botues: "Muessesetur-Risale", Bejrut 1985.
- Lane: Edward William Lane, fjalori "An Arabic-English Lexicon", botues: "Librairie du Liban", Bejrut 1968.
- Lisan el-Arab: Ibn Mendhur, fjalori "Lisanul-Arab", botues: "Es-Sader", Bejrut, 1300 h. / 1883.
- Mishkat: Khatib et-Tibrizi, "Mishkat el-Mesabih", botues: "El-Mektebel-islamij", Bejrut 1979.
- Mu'xhemul-Buldan: Jakut el-Hamavi, "Mu'xhemul-Buldan", shtëpia botuese: "El-Kutub el-'ilmijje", Bejrut, pa vit botimi.
- Mu'xhemul-Vesit: Grup autorësh, "El-Mu'xhemul-Vesit", botues: "Mektebe esh-shuruk ed-deulijje", Kajro 2004.
- Mufredat: Er-Ragib el-Isfahani, fjalori "Mufredat elfadhul-Kuran", botues: "El-Kalem", Damask, 1430 h. / 2009.
- Munxhid: Louis Malouf, fjalori "El-Munxhid fil-lugatil-a'lam", botues: "El-Mashrik", Bejrut 2008.
- Muslim: Muslim ibn El-Haxhaxh, "Sahih", botues: "Darus-Selam", Riad, 1421 h. / 2000.
- Musned Ahmed: Ahmed ibn Hanbel, "Musned", botues: "Muessesetu er-Risaleh", Bejrut, 1996.
- Nesai: Ebu 'Abdurrahman Ahmed en-Nesai, "Sunen", botues: "Mektebetul-Me'arif", Rijad, 1417 h. / 1996.
- Raziu: Imam Fahrudin er-Razi, "Tefsirul-Kebir (Mefatihul-Gajb)", botues "El-Fikr", Bejrut 1401 h. / 1981.
- Sujuti: Xheladullin es-Sujuti, "Te'jidul-hakikatul-'alijje", botues: "Kutub el-'ilmijje", Bejrut 2006.
- Sha'rani: 'Abdul-Vehhab esh-Sha'rani, "Levakihul-envar el-kudsijje fi bejanil-'uhud el-muhammedijje", Haleb 1993.
- Shevkaniu, "Fet'hul-Kadir": Imam Shevkani, "Fet'hul-Kadir", botues: "Darun-Nevarid", Kuvajt 2010.
- Ta'tirul-enam: 'Abdul-Gani en-Nabulsi, "Ta'tirul-enam fi ta'birul-menam", botues "Istikameh", Kajro 1964.
- Taberiu: Ibn Xherir et-Taberi, "Xhami 'ul-Bejan 'an te'vil ajil-Kur'an", botues: "Muessesetur-Risale", Bejrut, 1415 h. / 1993.
- Tabersi, "Mexhme'ul-Bejan...": Shejh Tabersi, "Mexhme'ul-bejan fi tefsirul-kur'an", botues: "Darul-Murteda", Bejrut 2006.
- Takvimul-Buldan: Ebul-Fidan, "Takvimul-Buldan", botues: "Mektebetu eth-thekafetud-dinijje", Kajro 2007.

- Taxh el-'Arus: El-Murteda el-Zebidi, fjalori "Taxh el-'Arus", botues: "Et-Turath el-'arabij", Kuvajt, 1418 h. / 1997.
- Tefsir i Bagaviut: Muhammed El-Ferra' El-Bagavi, "Me'alim et-Tenzil (Tefsir El-Bagavi)", botues: "Dar Tajjibe", Riad, 1409 h. / 1988.
- Tefsir Ruhul-Me'ani: Mahmud el-Alusi, "Ruhul-me'ani fi tefsiril-'adhim ve seb'ul-methani", botues: "El-Kutub el-'ilmijje", Bejrut, 1415 h./ 1994.
- Tirmidhi: Ebu Isa Muhammed ibn Isa et-Tirmidhi, "Xhami'ul-Kebir", botues: "Garbul-Islamij", Bejrut 1996.
- The Historians' History of the World: Henry Smith Williams, "The Historians' History of the World", botimi i parë në 25 vëllime u botuan në vitin 1902.
- Usdul-Gabeh: 'Ali ibn el-Ethir, "Usdul-gabeh fi ma'rifetus-sahabeh", botues: "El-Kutub el-'ilmijje", Bejrut 2008.
- William Muir: Sir William Muir, "The Life of Mohammad", Edinburgh, 1923.
- Zuhejli: Dr. Vehbeh ez-Zuhajli, "El-Fikhul-islami ve edil-letuhu", shtëpia botuese: "El-Fikr", Damask 2006.



# Shkurtesat

<i>savs:</i>	<i>Sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem</i> (Paqja e bekimi i Allahut qofshin mbi të!), shkruhet e lexohet kur përmendet emri i Hazret Profetit Muhammed <sup>savs</sup> .
<i>as:</i>	<i>Alejhis-selam</i> (Paqja qoftë mbi të!), shkruhet e lexohet kur përmendet emri i ndonjë Profeti të Allahut.
<i>ra:</i>	RadijAll-llahu anhu/anha/anhum (Allahu qoftë i kënaqur me të/ta!), shkruhet e lexohet kur përmendet emri i ndonjë <i>sahabi</i> a <i>sahabeje</i> të ndonjë Profeti.
<i>aba:</i>	Ajjedehull-llahu te‘ala binetrihil-‘aziz (Allahu e ndihmoftë fuqimisht!), shkruhet e lexohet kur përmendet emri i Kalifit të kohës.
<i>arab.:</i>	Arabisht.
<i>Enc.:</i>	Enciklopedi.

# Shpjegimet e fjalëve të huaja

<i>Ahiret:</i>	e mëvonshmja, bota e përtejme.
<i>Ajet:</i>	varg i Kuranit të Shenjtë; shenjë.
<i>Arsh:</i>	Froni i Zotit të Madhërishëm.
<i>Bejat:</i>	be, besëlidhje.
<i>Bismil-lah:</i>	ajeti i parë i çdo sureje, Bismil-lahirr-Rrahmanirr-Rrahim.
<i>Dua:</i>	lutje.
<i>Evljätë:</i>	miqtë (e Allahut). Shumësi i fjalës <i>veli</i> , që do të thotë mik.
<i>Fikh:</i>	jurisprudenca islame.
<i>Hak Mehr:</i>	dhurata martesore që dhëndri obligohet t'i japë nuses.
<i>Haxh:</i>	pelegrinazhi i muslimanëve që bëhet në Mekë, në muajt të caktuar.
<i>Hazret:</i>	shumë i nderuar.
<i>Ithram:</i>	gjendja e besimtarit në zonën e caktuar të Qabesë dhe në rrethinat e saj, me synimin për të bërë pelegrinazhin e haxhit ose të umresë; meshkujt gjatë kësaj kohe vishen me pëlthurë të bardhë, pa qepje, të përbërë nga dy pjesë, të sipërme dhe të poshtme.
<i>Itikaf:</i>	është mbyllja në xhami ose në ndonjë vend të veçantë, për të adhuruar Allahun ditë e natë, duke u shkëputur nga punët e botës. Ky adhurim intensiv veçanërisht bëhet në dhjetëditëshin e fundit të muajit të bekuar të Ramazanit.
<i>Keshf:</i>	vizion që përjetohet në zgjim, ose midis gjumit dhe zgjimit.
<i>Khula:</i>	divorci kur e kërkon gruaja.

<i>Kible:</i>	drejtim.
<i>Me'adhallah:</i>	kërkoj mbrojtjen e Allahut nga ky mendim!
<i>Medinase:</i>	që i përket Medinës.
<i>Mekase:</i>	që i përket Mekës.
<i>Nikah:</i>	shpallja e martesës në mënyrë islame.
<i>Ruku:</i>	pozicioni i përkuļjes në namaz.
<i>Sadaka:</i>	lēmoshë dhe ndihmë materiale vullnetare për nevojtarët që jepet sipas mundësisë dhe në kohë të pacaktuar. Çdo vepër e mirë që bëhet për hir të Zotit me sinqeritetin e zemrës.
<i>Sexhde:</i>	pozicioni i përkuļjes gjatë namazit kur falësi vë ballin dhe hundën në tokë në shenjë përulësie të skajshme para Zotit të Madhërishëm.
<i>Shirk:</i>	të barazosh dikë a diçka me Zotin e Madhërishëm, besimi në shumë zota, idhujtari.
<i>Sure:</i>	kapitull i Kuranit të Shenjtë.
<i>Takva:</i>	druajtje ndaj Zotit; devotshmëri ndaj Tij.
<i>Talak:</i>	divorci kur e kërkon burri.
<i>Tavaf:</i>	rrotullimi rreth Qabesë.
<i>Tefsir:</i>	komentim i Kuranit të Shenjtë.
<i>Umet:</i>	populli besimtar i një Profeti.
<i>Umre:</i>	vizita në Qabe në Mekë për adhurimin e Zotit.
<i>Xhizje:</i>	taksë që u vendosej jomuslimanëve në një shtet musliman për shërbime dhe mbrojtje shtetërore.
<i>Xhuz:</i>	pjesë.

# Kontakte

## **Shqipëri:**

Xhemati Musliman Ahmedia  
Rr. "Pavarësia"  
Mëzez, Tiranë  
Kutia postare 8176  
+355 67 216 8054  
+355 694 644 888  
[www.alislam.al](http://www.alislam.al)

## **Kosovë:**

Xhemati Musliman Ahmedia  
Rruga "Elbasani", nr. 9,  
Lagjja e Spitalit, 10000 Prishtinë  
[amj.kosovo@gmail.com](mailto:amj.kosovo@gmail.com)  
+383 44 817 813  
+383 44 578 886

---

## **Gjermani:**

Ahmadiyya Muslim Jamaat  
Baitus-Sabuh  
Genfer Str. 11  
60437 Frankfurt am Main, Germany  
+49 6950688600  
[www.ahmadiyya.de](http://www.ahmadiyya.de)

## **Britani e Madhe:**

The Baitul Futuh Mosque  
181 London Rd,  
Morden SM4 5PT, UK  
[www.alislam.org](http://www.alislam.org)

---

## **Zvicër:**

Ahmadiyya Muslim Jamaat  
Mahmud Moschee  
Forchstrasse 323  
8008 Zürich  
T +41443815570, F +41443822181  
[www.ahmadiyya.ch](http://www.ahmadiyya.ch)

## **Holandë:**

Ahmadiyya Moslim Gemeenschap  
Mobarak Moskee, Oostduinlaan 79,  
2596 JJ Den Haag  
T: 070-3245902, F: 070-3242881  
[www.islamnu.nl](http://www.islamnu.nl)

---

## **Italia:**

Bait-ut-Tauhid  
Via Morgobbo 1035/A  
40018 San Pietro in Casale (Bo)  
Italy; [contatti@alislam.it](mailto:contatti@alislam.it)  
Numero Verde: 800 598 005  
+39 051 199 00 451  
[www.alislam.it](http://www.alislam.it)

## **Bosnjë:**

Ahmadija muslimanski džemat  
Tuzlanska 1b, 71000 Sarajevo,  
Bosna i Hercegovina  
Tel/Fax.: 00387-33-612612  
[www.ahmadija.ba](http://www.ahmadija.ba)

**[www.alislam.al](http://www.alislam.al)**

**CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

Kurani i Shenjtë, përkthim dhe komentim i shkurtër / përkth.  
nga arab. Samad Ahmed Ghori ; red. Muhamet Peci, Rexhep  
Hasani. - Tiranë : Fondacioni "Xhemati Mysliman Ahmadi",  
2023. - 1318 f. : 15.6 x 23.4cm.

Tit. në angl. prej nga janë përkth. komentet: (The Holy Quran,  
Albanian translation with short commentary).

ISBN 9789928449160

1.Feja islame 2.Kurani 3.Kritika, interpretimi

28 -23 -273



